UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI JURIDIK

Prof.dr. Enver HASANI
Prof.ass.dr. Përparim GRUDA
Prof.ass.dr. Zahir ÇERKINI

E DREJTA KUSHTETUESE

Prishtinë, 2023

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI JURIDIK

Prof.dr. Enver HASANI
Prof.dr.ass. Përparim GRUDA
Prof.dr.ass. Zahir ÇERKINI

E DREJTA KUSHTETUESE

Prishtinë, 2023

Këshilli Botues i Universitetit të Prishtinës ”Hasan Prishtina” lejoi publikimin dhe përdorimin e këtij teksti me Vendimin nr. 1/835, datë 31.07.2023.

Recensentët:
Prof.dr. Faik Brestofci
Prof.dr. Iliriana Islami

Redaktor përgjegjës:
Prof.dr. Muhamet Mala

Redaktor profesional:
Prof.dr. Hajredin Kuçi

Lektor:
Arben Veseli

Dizajni:
Besnik Rexhepi

Shtypi:
N.T.G. “Blendi”, Prishtinë

Të gjitha të drejtat e autorit mbrohen me ligj.

PËRMBAJTJA

Parathënia ..... **xv**

PJESA E PARË
KUSHTETUTA DHE E DREJTA KUSHTETUESE **23**

1. Shqyrtime hyrëse **23**
2. Kuptimi, origjina dhe natyra e kushtetutës **24**
2.1. Kuptimi dhe origjina e kushtetutës 24
2.2. Natyra e kushtetutës 27
2.3. Kushtetuta në kuptimin material dhe formal 29
3. Mbi dy koncepte të rëndësishme dhe pashmangësisht të lidhura me kushtetutën: "grund-norma" dhe pushteti konstituiv **33**
4. Zhvillimi i konstitucionalizmit **36**
4.1. Zhvillimi i konstitucionalizmit në botë **36**
4.2. Zhvillimi i konstitucionalizmit në Kosovë, botën shqiptare dhe vendet përreth 39
5. E drejta kushtetuese **82**
5.1. E drejta kushtetuese si degë e sistemit juridik pozitiv, si disiplinë shkencore dhe metoda e të drejtëskushtetuese 82
5.1.1. E drejta kushtetuese si degë e sistemit juridik pozitiv 82
5.1.2. E drejta kushtetuese si disiplinë shkencore 83
5.1.3. Metoda e të drejtës kushtetuese 85
5.2. Marrëdhënia e të drejtës kushtetuese me degët tjera të së drejtës 86
5.3. Burimet e të drejtës kushtetuese 89
5.3.1. Burimet e të drejtës kushtetuese në Kosovë 103
5.3.2. Burimet e të drejtës kushtetuese në Shqipëri 106
5.3.3. Burimet e të drejtës kushtetuese në Maqedoni të Veriut 108
5.3.4. Burimet e të drejtës kushtetuese në Mal të Zi 113
5.3.5. Burimet e të drejtës kushtetuese në Serbi 115
6. Miratimi dhe ndryshimi i kushtetutës **118**
6.1. Procedura e miratimit dhe ndryshimit të kushtetutës 120
6.1.1. Miratimi i kushtetutës së parë 122
6.1.2. Miratimi i kushtetutës së radhës 124
6.1.3. Ndryshimi formal dhe faktik i kushtetutës 124
6.2. Miratimi dhe ndryshimi i kushtetutës së Kosovës dhe i vendeve përreth saj 127
7. Ndarjet e kushtetutave **132**
8. Struktura dhe renditja e kushtetutës, me vështrim të posaçëm në Kushtetutën e Kosovës dhe kushtetutat e vendeve përreth saj **135**
9. Shteti dhe parimet themelore të konstitucionalizmit modern **142**
9.1. Shteti dhe ndarjet e tij 142
9.2. Parimet themelore të konstitucionalizmit modern 147
9.2.1. Demokracia dhe sundimi i ligjit 148
9.2.2. Liria dhe epërsia e të drejtave të njeriut 149
9.2.3. Sovraniteti, legaliteti dhe legjitimiteti 150
9.2.4. E drejta në rezistencë, kufizimi dhe kontrollimi i pushtetit 151
10. Komente dhe pyetje **153**
11. Lexim shtesë **163**

PJESA E DYTË
LIRITË DHE TË DREJTAT E NJERIUT.....167

1. Përgjithësisht mbi liritë dhe të drejtat e njeriut.....167
2. Burimet juridiko-politike mbi të drejtat e njeriut.....171
2.1. Deklaratat e para mbi liritë dhe të drejtat e njeriut.....172
2.2. Aktet e mëvonshme ndërkombëtare mbi liritë dhe të drejtat e njeriut.....174
2.3. Liritë dhe të drejtat e njeriut në kushtetutë.....176
3. Ndarja e lirive dhe të drejtave të njeriut.....178
4. Kushtet dhe parimet e realizimit të lirive dhe të drejtave të njeriut.....182
5. Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut.....188
6. Disa nga liritë dhe të drejtat e njeriut 191
6.1. Liritë dhe të drejtat personale.....191
6.1.1. E drejta për jetë.....191
6.1.2. Liria personale.....193
6.1.3. Liria e lëvizjes.....195
6.1.4. Liria e mendimit dhe shprehjes.....196
6.1.5. Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë.....198
6.1.6. E drejta e privatësisë.....199
6.1.7. Të drejtat personale që formojnë të drejtën për gjykim të drejtë.....201
6.2. Liritë dhe të drejtat politike.....204
6.2.1. E drejta zgjedhore.....204
6.2.2. Liria e shtypit.....206
6.2.3. Liria e asociimit.....208
6.3. Liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore.....209
6.3.1. E drejta për punë dhe të drejtat tjera lidhur me punën.....212
6.3.2. E drejta për mbrojtjen e shëndetit.....214
6.3.3. E drejta për arsim.....215
6.4. Detyrimet e qytetarit.....216
6.5. Të drejtat e të huajve dhe e drejta për shtetësi.....217
6.6. Të drejtat dhe liritë e posaçme të minoriteteve nacionale.....218
7. Liritë dhe të drejtat njerëzore dhe të minoriteteve në Kushtetutën e Kosovës dhe në kushtetutat e vendeve përreth saj.....220
7.1. Kushtet e realizimit të lirive dhe të drejtave njerëzore në Kosovë.....221
7.1.1. Kushtet e realizimit të lirive dhe të drejtave njerëzore në Shqipëri.....223
7.1.2. Kushtet e realizimit të lirive dhe të drejtave njerëzore në Maqedoninë e Veriut.....226
7.1.3. Kushtet e realizimit të lirive dhe të drejtave njerëzore në Mal të Zi.....229
7.1.4. Kushtet e realizimit të lirive dhe të drejtave njerëzore në Serbi.....231
7.2. Kufizimet e lirive dhe të drejtave të njeriut në Kosovë.....232
7.2.1. Kufizimet e lirive dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri.....234
7.2.2. Kufizimet e lirive dhe të drejtave të njeriut në Maqedoninë e Veriut.....236
7.2.3. Kufizimet e lirive dhe të drejtave të njeriut në Mal të Zi.....237
7.2.4. Kufizimet e lirive dhe të drejtave të njeriut në Serbi.....238
7.3. Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut në Kosovë.....239
7.3.1. Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri.....250
7.3.2. Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut në Maqedoninë e Veriut.....256
7.3.3. Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut në Mal të Zi.....260
7.3.4. Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut në Serbi.....264
7.4. Detyrimet e qytetarit në Kosovë.....269
7.4.1. Detyrimet e qytetarit në Shqipëri.....271
7.4.2. Detyrimet e qytetarit në Maqedoninë e Veriut.....272

7.4.3. Detyrimet e qytetarit në Mal të Zi....273
7.4.4. Detyrimet e qytetarit në Serbi....273
7.5. Të drejtat e të huajve në Kosovë....274
7.5.1. Të drejtat e të huajve në Shqipëri....275
7.5.2. Të drejtat e të huajve në Maqedoninë e Veriut....276
7.5.3. Të drejtat e të huajve në Mal të Zi....276
7.5.4. Të drejtat e të huajve në Serbi....277
7.6. Të drejtat e minoriteteve në Kosovë....278
7.6.1. Të drejtat e minoriteteve në Shqipëri....282
7.6.2. Të drejtat e minoriteteve në Maqedoninë e Veriut....283
7.6.3. Të drejtat e minoriteteve dhe anëtarëve të tyre në Mal të Zi....285
7.6.4. Të drejtat e minoriteteve dhe anëtarëve të tyre në Serbi....287
8. Komente dhe pyetje....288
9. Leximshtesë....294

PJESA E TRETË
ZGJEDHJET....297

1. Përgjithësisht mbi kuptimin e zgjedhjeve dhe historikun e tyre....297
1.1. Historiku....298
1.2. Konceptet themelore....299
2. Burimet e të drejtës zgjedhore....300
3. E drejta e zgjedhjes....302
3.1. Kushtet për fitimin e të drejtës aktive zgjedhore dhe cilësitë e saj....303
3.2. Kushtet për fitimin dhe realizimin e të drejtës pasive zgjedhore....306
4. E drejta e votës dhe parakushtet për realizimin e saj....309
4.1. E drejta e votës....309
4.2. Regjistri i votuesve....310
4.3. Listat zgjedhore....311
4.4. E drejta për informim mbi zgjedhjet dhe fushata zgjedhore....312
5. Procedura zgjedhore dhe njësitë zgjedhore....313
5.1. Procedura zgjedhore....314
5.2. Njësitë zgjedhore....315
5.3. "Xherimanderingu"....316
6. Sistemet zgjedhore (sistemi i shpërndarjes së mandateve)....317
7. Llojet e sistemeve zgjedhore proporcionale....320
8. Mbikëqyrja e zgjedhjeve, mbrojtja e të drejtave zgjedhore dhe sanksionet....321
8.1. Mbikëqyrja e zgjedhjeve....321
8.2. Mbrojtja e të drejtës së zgjedhjes dhe sanksionet....323
9. Zgjedhjet në Kosovë....324
9.1. Pasqyrë e zgjedhjeve të deritanishme parlamentare....324
9.2. Llojet e zgjedhjeve, burimet dhe e drejta zgjedhore....329
9.3. Elementet themelore të sistemit zgjedhor....330
9.4. Realizimi i zgjedhjeve....334
9.4.1. Realizimi i zgjedhjeve për përfaqësues të popullit – veprimet zgjedhore....334
9.4.2. Realizimi i zgjedhjeve për Presidentin e Republikës....338
9.4.3. Realizimi i zgjedhjeve lokale – veprimet zgjedhore....338
10. Zgjedhjet në Shqipëri....341
10.1. Pasqyrë e zgjedhjeve të deritanishme parlamentare....341
10.1.1. Sistemi elektoral për zgjedhjet në Kuvendin Popullor në vitin 1991 dhe rezultatet....342
10.1.2. Sistemi elektoral për zgjedhjet në Kuvendin Popullor në vitin 1996....342

10.1.3. Sistemi zgjedhor i zbatuar në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2009.....342
10.1.4. Sistemi zgjedhor i zbatuar në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2013.....343
10.1.5. Sistemi zgjedhor i zbatuar në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017.....343
10.1.6. Sistemi zgjedhor i zbatuar në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2021.....343
10.2. Tiparet e sistemeve elektorale në Shqipëri.....345
10.3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe administrimi i zgjedhjeve.....346
10.4. Vota diasporës në zgjedhjet e vitit 2021.....347
10.5. Caktimi i numrit të mandateve dhe zonave zgjedhore.....347
10.6. Përfaqësimi gjinor 347
10.7. Ndarja e mandateve në zgjedhjet parlamentare.....348
10.8. Vëzhgues në zgjedhje.....348
10.9. Kolegji Zgjedhor.....348
10.10. Zgjedhjet lokale.....349
11. Zgjedhjet në Maqedoninë e Veriut.....349
11.1. Pasqyrë e zgjedhjeve të deritanishme parlamentare.....349
11.1.1. Sistemi elektoral për zgjedhjet në Kuvendin Popullor në vitin 1990.....350
11.1.2. Sistemi elektoral për zgjedhjet në Kuvendin Popullor në vitin 1994.....350
11.1.3. Sistemi elektoral për zgjedhjet në Kuvendin Popullor në vitin 1998.....350
11.1.4. Sistemi elektoral për zgjedhjet në Kuvendin Popullor në vitin 2002.....351
11.1.5. Sistemi elektoral për zgjedhjet në Kuvendin Popullor në vitin 2006.....351
11.1.6. Sistemi elektoral për zgjedhjet në Kuvendin Popullor në vitin 2008.....351
11.1.7. Sistemi elektoral për zgjedhjet në Kuvendin Popullor në vitin 2011.....351
11.1.8. Sistemi elektoral për zgjedhjet në Kuvendin Popullor në vitin 2014.....352
11.1.9. Sistemi elektoral për zgjedhjet në Kuvendin Popullor në vitin 2016.....352
11.1.10. Sistemi elektoral për zgjedhjet në Kuvendin Popullor në vitin 2020.....352
11.2. Sistemi zgjedhor aktual në MV.....353
11.3. Organet zgjedhore.....354
11.4. E drejta e zgjedhjes aktive dhe pasive, procedura e paraqitjes së kandidaturave.....355
11.5. Vëzhgimi zgjedhjeve.....357
11.6. Zgjedhjet lokale dhe organet për zhvillimin e tyre.....357
11.7. Zgjedhjet presidenciale.....358
12. Zgjedhjet në Mal të Zi.....358
12.1. Kuadri kushtetues e ligjor i sistemit zgjedhor në Mal të Zi.....358
12.2. Sistemizgjedhor.....359
12.3. Metoda e shpërndarjes së mandateve.....360
12.4. Numri dhe madhësia e njësive zgjedhore.....362
12.5. Shpërndarja e mandateve.....362
12.6. Masat institucionale për ngritjen e pjesëmarrjes së grave.....364
12.7. Zgjedhjet lokale.....364
12.8. Zgjedhjet presidenciale.....364
13. Zgjedhjet në Serbi.....365
13.1. Pasqyrë e zgjedhjeve të deritanishme parlamentare.....365
13.2. Llojet e zgjedhjeve, burimet e të drejtës dhe e drejta zgjedhore.....366
13.3. Elementet themelore të sistemit zgjedhor.....367
13.4. Realizimi i zgjedhjeve.....366
13.4.1. Realizimi i zgjedhjeve për përfaqësues të popullit – veprimet zgjedhore.....368
13.4.2. Realizimi i zgjedhjeve për Presidentin e Republikës – veprimet zgjedhore.....368
13.4.3. Realizimi i zgjedhjeve për deputetët e KKV.....370
13.4.4. Realizimi i zgjedhjeve lokale – veprimet zgjedhore.....370
14. Institutet e demokracisë së drejtpërdrejtë – iniciativa popullore dhe referendum.....371
15. Iniciativa dhe referendumi në Kosovë.....375

16. Iniciativa dhe referendumi në Shqipëri....376
17. Iniciativa dhe referendumi në Maqedoninë e Veriut....377
18. Referendumi në Mal të Zi....378
19. Iniciativa dhe referendumi në Serbi....379
20. Partitë politike....381
21. Komente dhe pyetje....385
22. Lexim shtesë....388

PJESA E KATËRT
ORGANIZIMI HORIZONTAL I PUSHTETIT....391

1. Mbi organizimin e pushtetit....391
1.1. Funksionet....393
1.2. Organizimi i pushtetit: teoria dhe praktika....396
1.3. Sistemet e pushtetit....408
1.3.1. Sistemi presidencial....408
1.3.2. Sistemi parlamentar....411
1.3.3. Sistemi i kuvendeve....413
2. Parlamenti....414
2.1. Emri dhe prejardhja e parlamentit....414
2.2. Zgjedhja, struktura, përbërja, legjitimiteti dhe madhësia e parlamentit....416
2.3. Mandati i deputetëve....418
2.4. Kompetenca....420
2.5. Organizimi i brendshëm....424
2.6. Mënyra e punës dhe vendosjes....425
2.7. Procedura e ligjvënies....427
2.8. Shpërndarja e parlamentit....431
3. Kuvendi i Kosovës: historia dhe zhvillimi....433
3.1. Zgjedhja, madhësia, struktura, përbërja dhe legjitimiteti....434
3.2. Mandati i deputetëve....436
3.3. Kompetencat....442
3.4. Organizimi i brendshëm....444
3.5. Mënyra e punës dhe e vendosjes....446
3.6. Procedura ligjvënëse....447
3.7. Shpërndarja....451
4. Kuvendi Shqipërisë....452
5. Kuvendi Maqedonisë së Veriut....455
6. Kuvendi i Malit të Zi....458
7. Kuvendi i Serbisë....460
8. Shefi i shtetit: kuptimi dhe origjina....462
8.1. Marrja e pushtetit....464
8.2. Mandati i presidentit të republikës....466
8.3. Kompetenca....467
8.4. Përgjegjësia....468
9. Presidenti i Kosovës....470
9.1. Pozita kushtetuese....470
9.2. Kompetencat....476
9.3. Kualifikimi, zgjedhja, mandati dhe mbarimi (përfundimi) i mandatit....492
9.4. Papajtueshmëria....494
9.5. Imuniteti....495
9.6. Mungesa e përkohshme e presidentit....496

9.7. Shkarkimi presidentit....497
10. Presidenti i Shqipërisë....498
11. Presidenti i Maqedonisë së Veriut....499
12. Presidenti i Malit të Zi....501
13. Presidenti i Serbisë....502
14. Ekzekutivi....504
14.1. Origjina dhe llojet e qeverisë....504
14.2. Zgjedhja dhe mandati....507
14.3. Kompetenca....509
14.4. Përgjegjësia e qeverisë dhe të drejtat e saj ndaj parlamentit....511
15. Qeveria e Kosovës: parimet e përgjithshme....512
15.1. Kompetencat e qeverisë....515
15.2. Kompetencat e kryeministrit....521
15.3. Zgjedhja e qeverisë....527
15.4. Ministritë dhe përfaqësimi i komuniteteve....530
15.5. Përgjegjësia....532
15.6. Imuniteti dhe vendimmarrja....533
15.7. Mosbesimi dhe votëbesimi....534
15.8. Shërbimi civil....535
16. Qeveria e Shqipërisë....536
17. Qeveria e Maqedonisë së Veriut....537
18. Qeveria e Malit të Zi....539
19. Qeveria e Serbisë....540
20. Gjykatat....542
20.1. Mbi natyrën e pushtetit gjyqësor....542
20.2. Parimet ndërkombëtare mbi gjykatat....543
20.3. Statusi juridik i gjyqtarëve....546
20.4. Parimet procedurale si garancione të pavarësisë së gjykatës....548
20.5. Organizimi i pushtetit gjyqësor....549
21. Sistemi drejtësisë në Republikën e Kosovës....550
21.1. Sistemi drejtësisë deri më 1969....551
21.2. Sistemi drejtësisë deri më 23 mars 1989....552
21.3. Sistemi drejtësisë nën administratën UNMIK....553
21.4. Sistemi drejtësisë pas shpalljes së pavarësisë....556
22. Sistemi drejtësisë në Shqipëri....559
23. Sistemi drejtësisë në Maqedoninë e Veriut....565
24. Sistemi drejtësisë në Mal të Zi....568
25. Sistemi drejtësisë në Serbi....570
26. Gjyqësia kushtetuese: funksioni dhe sistemet....578
26.1. Kushtetutshmëria dhe ligjshmëria dhe kontesti kushtetues....580
26.2. Përbërja e organit të gjyqësisë kushtetuese....584
26.3. Kompetenca e organit të gjyqësisë kushtetuese....586
27. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës....587
27.1. Historiku....587
27.2. Përbërja, mandati dhe statusi i gjyqtarëve kushtetues....598
27.3. Statusi....607
27.4. Papajtueshmëria....607
27.5. Imunitetet dhe shkarkimi....612
27.6. Kompetenca dhe vendimet....616
27.7. Juridiksioni i kufizuar (gjatë pavarësisë së mbikëqyrur dhe pas themelimit të Gjykatës Specia le)....617

27.8. Juridiksioni aktual i Gjykatës Kushtetuese....618
27.9. Llojet e vendimeve....619
28. Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë....623
29. Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut....627
30. Gjykata Kushtetuese e Malit të Zi....629
31. Gjykata Kushtetuese e Serbisë....632
32. Ushtria dhe policia....636
32.1. Kuptimi dhe format e ushtrisë....636
32.2. Parimet e organizimit dhe pozita e ushtrisë në rendin demokratik....637
32.3. Ushtria si institucion kushtetues....639
32.4. Policia: Kuptimi dhe roli....641
33. Ushtria dhe policia në Kosovë....644
34. Ushtria dhe policia në Shqipëri....648
35. Ushtria dhe policia në Maqedoninë e Veriut....650
36. Ushtria dhe policia në Mal të Zi....651
37. Ushtria dhe policia në Serbi....651
38. Autoritetet e pavarura rregullative (agjencitë dhe institucionet e pavarura)....653
38.1. Agjencitë dhe institucionet e pavarura në Kosovë....662
38.2. Agjencitë dhe institucionet e pavarura në Shqipëri....664
38.3. Agjencitë dhe institucionet e pavarura në Maqedoninë e Veriut....665
38.4. Agjencitë dhe institucionet e pavarura në Mal të Zi....666
38.5. Agjencitë dhe institucionet e pavarura në Serbi....666
39. Komente dhe pyetje....667
40. Lexim shtesë....676

PJESA E PESTË
ORGANIZIMI VERTIKAL I PUSHTETIT....679

1. Mbi ndarjen vertikale të pushtetit dhe format e rregullimit shtetëror....679
2. Shteti unitar....683
2.1. Karakteristikat, punët dhe llojet e shtetit unitar....684
2.1.1. Shteti unitar i decentralizuar....686
2.1.2. Shteti unitar i centralizuar....687
3. Shteti i përbërë....688
3.1. Unioni....688
3.1.1. Unioni personal....689
3.1.2. Unioni real....690
3.1.3. Bashkimi Evropian....691
3.2. Konfederata....691
4. Federata....694
4.1. Federalizmi....694
4.1.1. Arsyet për themelimin e federatave....696
4.1.2. Llojet e federatave....698
4.2. Statusi juridiko-kushtetues....701
4.2.1. Kushtetuta federale....702
4.2.2. Sistemi juridik në federatë....704
4.2.3. Subjektiviteti shtetëror-juridik dhe sovraniteti i federatës....705
4.2.4. Ndarja e kompetencave në federatë....707
4.2.5. Organet e pushtetit në federatë....709
4.2.6. Statusi juridik-kushtetues i njësive federale....711
5. Shtetet regjionale....712

5.1. Kuptimi dhe shembujt e shtetit regjional....712
5.2. Emërtimet e ndryshme dhe themelimi i regjioneve....715
5.3. Organizimi i pushtetit, kompetencat dhe mbrojtja juridike e vetëqeverisjes regjionale....717
6. Shteti regjional në Kosovë dhe vendet fqinje....720
6.1. Kosova....720
6.2. Shqipëria....724
6.3. MaqedoniaVeriut....725
6.4. Mali i Zi....725
6.5. Serbia....725
7. Autonomia territoriale....726
7.1. Vështrim i përgjithshëm....726
7.2. Cilësitë juridike të autonomisë territoriale....728
8. Autonomia territoriale: përfundimet....729
9. Autonomia territoriale në Kosovë dhe vendet fqinje....730
9.1. Kosova....730
9.2. Shqipëria....737
9.3. Maqedonia Veriut....738
9.4. Mali i Zi....739
9.5. Serbia....739
10. Vetëqeverisja lokale....741
10.1. Kuptimi dhe lindja e vetëqeverisjes lokale....741
10.2. Marrëdhëniet me pushtetin qendror dhe realizimi demokratik i vetëqeverisjes lokale....743
10.3. Llojet dhe format e vetëqeverisjes lokale....744
10.4. Organizimi i pushtetit në vetëqeverisjen lokale....746
10.5. Kompetencat dhe financimi i vetëqeverisjes lokale....748
10.6. Kontrolli dhe mbrojtja e vetëqeverisjes lokale....750
11. Vetëqeverisja lokale në Kosovë dhe vendet përreth....751
11.1. Kosova....751
11.1.1. Historiku deri në nxjerrjen e Kushtetutës së RSFJ-së 1974 dhe Kushtetutës së KSAK-së (1974) 751
11.1.2. Periudha para fitimit të pavarësisë: nga nxjerra e kushtetutës së RSFJ-së 1974 dhe kushtetutës së KSAK-së....755
11.1.3. Periudha pas fitimit të pavarësisë – nga Kushtetuta e Kaçanikut deri te shpallja e pavarësisë më 17 shkurt 2008 dhe tutje....756
11.2. Shqipëria....790
11.2.1. Historiku....790
11.2.2. Ndikimi i standardeve ndërkombëtare në qeverisjen vendore....791
11.2.3. Organizimi i qeverisjes vendore....792
11.2.4. Ushtrimi vetëqeverisjes nëpërmjet organeve të zgjedhura....794
11.2.5. Qeverisja vendore në praktikën e GJKShq....795
11.2.6. Referendumet vendore....796
11.3. Maqedonia e Veriut....797
11.3.1. Historiku....797
11.3.2. Kuadrijuridik....797
11.3.3. Pushteti lokal dhe autonomia e tij....798
11.3.4. E drejta për asociim dhe bashkëpunimi ndërkomunal....800
11.3.5. Kompetencat....800
11.3.6. Organet e pushtetit lokal....801
11.4. Mali i Zi....806
11.4.1. Historiku....806
11.4.2. Kuadri pozitivo-juridik deri në pavarësimin e Malit të Zi....806

11.4.3. Kuadri juridiko-pozitiv i vetëqeverisjes lokale sot....809
11.4.4. Kompetencat e vetëqeverisjes lokale....810
11.4.5. Organizimi i vetëqeverisjes lokale....812
11.4.6. Mbrojtja e vetëqeverisjes lokale....816
11.5. Serbia....817
11.5.1. Pozita kushtetuese e vetëqeverisjes lokale....817
11.5.2. Organizimi i pushtetit të vetëqeverisjes lokale....821
12. Komente dhe pyetje....823
13. Leximshtesë....831

Literatura....833
Indexi....867
Shënime për autorët....907

Parathënie

Libri që sot lexuesi ka në dorë është rezultat i një pune pesë vjeçare. Ideja për të u ngjiz në Korçë, më 7 shtator 2018 në përvjetorin e Kushtetutës së Kaçanikut, në njërin prej restoranteve të bukura të Pazarit të Vjetër. E kemi parasysh që ky është një projekt shumë ambicioz, megjithatë, në bukurinë e Korçës, gjatë darkës me verë të mirë e me serenata korçare, lindin edhe projekte ambicioze. Kur u kthyem, idenë ia paraqitëm autorit të tretë, prof. Zahirit. Ne të dy ishim me dr. Sokol Krasniqin, një pedagog i Stomatologjisë në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", i cili na inkurajoi për fillimin e implementimit të idesë sonë. E falenderojmë nga zemra për këtë, sot që libri po e sheh dritën e botimit.

Libri i dedikohet në rend të parë studentëve të fakulteteve juridike shqipfolëse, sepse në të trajtohen, pos dhe krahas aspekteve të thella juridiko-teorike të kategorive, instituteve e institucioneve të së drejtës kushtetuese, edhe aspektet pozitive juridiko-kushtetuese të Kosovës dhe vendeve përreth.

Pa asnjë dyshim, lexuesi, që jodomosdo kërkohet të jetë nga fusha e drejtësisë, në këtë libër do të gjejë përgjigjen në pothuajse çdo pyetje nga e drejta kushtetuese. Kjo është edhe arsyeja e këtij vëllimi jo të zakonshëm, tepër voluminoz për një tekst universitar dhe për një lëndë që mësohet vetëm një semestër. Trajtimet tona nuk janë kufizuar dhe as që kanë pasur për pikë referimi planin dhe programin e kësaj lënde nëpër fakultetet tona juridike, për shkak se këto trajtime nuk kanë për target vetëm studentët e drejtësisë (në cilindo nivel të studimeve), por lexuesin kurioz për të ditur çdo gjë për dhe rreth të drejtës kushtetuese, me fillim nga konceptet e saj bazike e deri te zgjidhjet juridiko-kushtetuese të së drejtës pozitive në Kosovë dhe vendet përreth.

Lista e atyre që duam të falenderojmë është e gjatë: recenzentët e librit, Prof.dr. Faik Brestofci dhe Prof.dr. Iliriana Islami, redaktorin përgjegjës Prof.dr. Muhamet Mala, redaktorin profesional Prof.dr. Hajredin Kuçi, dhe ata që na kanë furnizuar me burimet e literaturës më të përditësuar të mundshme, siç është studiuesi i ri dhe konstitucionalisti me perspektivë Jeton Hasani, prof. Safet Emruli nga Tetova, lektorin Arben Veseli, e deri te familjet tona që patën aq mirëkuptim për të duruar mungesën e familjarëve të tyre gjatë ditëve e netëve të gjata pa gjumë e me kokën mbi libra dhe "llap-top". Në veçanti, përulemi për sakrificën e bashkëshorteve tona, që patën mirësinë për marrjen përsipër të detyrimeve shtesë në edukimin dhe udhëheqjen e fëmijëve tanë, të cilëve u munguam aq shumë.

Libri përmban pesë pjesë. Në çdo pjesë, përveç burimeve të dhëna në fusnota, në fund është ofruar një listë e literaturës shtesë si sugjerim për lexuesin, pyetjet dhe komentet për studentë. Për ta bërë më të lehtë për lexuesin përdorimin e burimeve në fusnota, çdo pjesë e ka rendin e vet të numrit të fusnotave të pavarur nga pjesët e tjera.

Përkundër kontributit e këshillave të shumta që kanë dhënë shumë kolegë nga komuniteti i juristëve të botës shqiptare, prapë se prapë e tërë përgjegjësia për çfarëdo lëshimi profesional në këtë libër ngelet e jona dhe e askujt tjetër.

Autorët

Lista e shkurtesave:

- A/BKS- Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe
- AKI- Agjencia Kosovare e Inteligjencës
- AP- Asambleja e Përgjithshme e OKB-se
- AP-Avokati Popullit
- ASK- Asociacioni i Komunave të Kosovës
- ASNOM- Këshilli Antifashist i Çlirimit të Maqedonisë
- AupKos-Auditori Përgjithshëm
- BE- Bashkimi Evropian
- BQK- Banka Qendrore e Kosovës
- BRSS- Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike
- BSHSMZi- Bashkësia Shtetërore Serbi Mali i Zi
- DUDNJ- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
- FPR- Formulari i Përputhjes së Rezultateve
- FRK- Formulari i Rezultatit të Kandidatëve
- GJEDNJ- Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- GJKAust- Gjykata Kushtetuese e Austrisë
- GJKÇek- Gjykata Kushtetuese e Çekosllovakisë
- GJKGJe- Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë
- GJKIt-Gjykata Kushtetuese e Italisë
- GJKMVe- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë
- GJKMZi- Gjykata Kushtetuese e Malit të Zi
- GJKRKS-Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës
- GJKSerb- Gjykata Kushtetuese e Serbisë
- GJKSp- Gjykata Kushtetuese e Spanjës
- GJKShq- Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë
- GJLSH- Gjykata e Lartë e Shqipërisë
- GJMZi- Gjykata Kushtetuese e Malit të Zi
- GJND- Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë
- GJPDN- Gjykata Permanente e Drejtësisë Ndërkombëtare
- GJSAm-Gjykata Supreme Amerikane
- GJSKa- Gjykata Supreme e Kanadasë
- GJSKos-Gjykata Supreme e Kosovës
- GJSMZi- Gjykata Supreme e Mali të Zi
- GJSSerb- Gjykata Supreme e Serbisë
- ILD- Inspektori i Lartë i Drejtësisë
- IPVQ- Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë
- IRJM- Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë
- ISHRMZi- Institucioni Shtetëror i Revizionit i Malit të Zi
- KAKM- Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë
- KAÇKJ - Këshilli Anitifashist i Çlirimit Kombëtar të Jugosllavisë
- KAm- Kushtetuta e SHBA e vitit 1787
- KAV- Krahina Autonome e Vojvodinës
- KDIK- Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve
- KE- Këshilli i Evropës
- KED- Këshilli i Emërimeve në Drejtësi
- KEDNJ- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- KEK- Këshilli Ekzekutiv Krahinor
- KEVL- Karta evropiane për vetëqeverisjen lokale
- KEVR- Karta evropiane për vetëqeverisjen regjionale
- KFr- Kushtetuta e Francës
- Kit- Kushtetuta e Italisë
- KJ 1931- Kushtetuta e Mbretërisë Jugosllave e vitit 1931

- KJ 1946- Kushtetuta e parë e Jugosllavisë komuniste e vitit 1946
- KKaç- Kushtetuta e Kaçanikut
- KKos-Kushtetuta e Republikës së Kosovës e vitit 2008
- KKSerb- Kushtetuta Krahinore e Serbisë
- KKSMZi- Karta Kushtetuese e Serbisë dhe Malit të Zi
- KKV- Kuvendi i Krahinës Autonome të Vojvodinës
- KKZ- Komisioni Komunal i Zgjedhjeve
- KLGJ- Këshilli i Lartë Gjyqësor
- KLSH- Kontrolli i Lartë i Shtetit
- KMSMZi- Këshilli i Mbrojtjes dhe Sigurisë i Malit të Zi
- KMShq- Këshilli i Ministrave
- KMVe- Kushtetuta e Maqedonisë së Veriut
- KMZi 1992- Kushtetuta e Malit të Zi e vitit 1992
- KMZi- Kushtetuta e Malit të Zi
- KOS- Kisha Ortodokse Serbe
- KPK- Këshilli Popullor Krahinor
- KPK- Këshilli Prokurorial i Kosovës
- KPM- Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës
- KPM- Komisioni i Pavarur i Mediave
- KPRS- Kuvendi Popullor të Republikës së Serbisë
- KPZ- Këshillat e posaçëm zgjedhorë
- KQZ- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
- KRZ- Komisioni Republikan Zgjedhor
- KRRT- Këshilli i Rregullimit të Territorit
- KS 1947- Kushtetuta e Republikës Popullore të Serbisë e vitit 1947
- KSAK- Krahina Socialiste Autonome e Kosovës
- KSE- Karta Sociale Evropiane
- KSerb 1990- Kushtetuta e Serbisë e vitit 1990
- KSerb-Kushtetuta e Serbisë
- KSp- Kushtetuta e Spanjës e vitit 1978
- KSh- Kushtetuta e Shqipërisë
- KSHZ- Komisioni Shtetëror Zgjedhor
- KuvMZi- Kuvendi i Malit të Zi
- KV- Komisioni i Venecias
- Kvid- Kushtetuta e Vidovdanit
- KVV- Kryesuesi i Këshillit të Vendvotimit
- KZ- Këshillat Zgjedhore
- KZK- Komisioni Zgjedhor Krahinor
- KZShq- Kodi Zgjedhor i Shqipërisë
- KZv- Kushtetuta e Zvicrës
- LDK- Lidhja Demokratike e Kosovës
- LDKK- Ligji për Dispozitat Kryesore Kushtetuese
- LK 1953- Ligji Kushtetues i Jugosllavisë
- LTH- Ligji Themelor të Gjermanisë
- MA 2013- Marrëveshja e vitit 2013 mes Kosovës dhe Serbisë
- MJug- Mbretëria Jugosllave
- MKVZ- Misioni i Kufizuar i Vëzhgimit të Zgjedhjeve
- MO- Marrëveshja e Ohrit
- Mbretëria SKS- Mbretëria Serbo-Kroato-Sllovene
- MV - Maqedonia e Veriut
- NATO- Aleanca e Atlantikut të Veriut
- NUTS- Nomenclature of Territorial Units for Statistics
- OKB- Organizata e Kombeve te Bashkuara
- OSBE/ODIHR- Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë
- PDCP- Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike

- PDESK- Paktin për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore
- PDK- Partia Demokratike e Kosovës
- PKJ - Partia Komuniste e Jugosllavisë
- PNDCP- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
- PrMZi- Presidenti i Malit të Zi
- PSSP - Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së
- PZAP- Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
- QeMVe- Qeveria e Maqedonisë Veriore
- QeMZi- Qeveria e Malit të Zi
- QNR - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve
- RDFJ- Republika Federale Demokratike të Jugosllavisë
- RFJ- Republika Federale e Jugosllavisë
- RP- Rregullorja e Punës
- SHBA- Shtetet e Bashkuara te Amerikës
- SHISH-Shërbimin Informativ i Shtetit
- TMK- Trupave Mbrojtëse të Kosovës
- UÇK- Ushtria Çlirimtare e Kosovës/Ushtria Çlirimtare e Kombëtare
- UDBA- Policia Sekrete Komuniste (“Uprava Državne Bezbednosti”)
- UNMIK- Misioni i Administratës se Kombeve te Bashkuara ne Kosovë

PJESA E PARË 1

KUSHTETUTA DHE E DREJTA KUSHTETUESE

1. Shqyrtime hyrëse

Në traditën e sistemit juridik kontinental (civil) të së drejtës, kushtetuta është akti më i lartë juridik në vend. Ajo përmban norma juridike. Këtë cilësi brenda sistemit juridik, kushtetuta e fiton për shkak të fuqisë së vet juridike, duke u mbivendosur ndaj rregullave të tjera-ligjeve në rend të parë, rregulloreve, urdhëresave dhe dekreteve, vendimeve dhe akteve të tjera nënligjore.

Krahas kësaj, kushtetuta është edhe akt politik. Kjo për faktin se, ajo shërben si simbol i shtetit dhe pavarësisë së tij, simbol që legjitimon shtetin në marrëdhëniet me shtetet tjera dhe bashkësinë ndërkombëtare. Ky legjitimim nënkupton se shteti posedon pushtetin sovran në territorin e vet, që është pushtet legjitim pikërisht për faktin se organizimi dhe funksionimi i tij përcaktohet me kushtetutë, përfshirë përcaktimin e rolit dhe pozitës së individit në shoqëri. Këto dimensione bëjnë dallimin në mes të kushtetutës së njësive federale, entitete që nganjëherë posedojnë të drejtën për kushtetutat e tyre, por nuk janë shtete të pavarura dhe sovrane. Kjo nuk vlen për shtetet e pavarura dhe sovrane, të cilat pa asnjë përjashtim kanë kushtetutat e tyre, përfshirë vendet e sistemit të së drejtës së përgjithshme (kushtetuta në kuptimin material ose kushtetuta materiale), siç do të shohim më pastaj në këtë libër.

E drejta kushtetuese është degë e të drejtës publike dhe pjesë e sistemit juridik të shtetit. Si degë e të drejtës publike, objekt i saj i hulumtimit dhe studimit është **materia kushtetuese** (**materia constitutionis**). Në anën tjetër, e drejta kushtetuese përbëhet nga e drejta pozitive në fuqi dhe dispozitat tjera të pashkruara që normojnë materien kushtetuese. Në mes të drejtës kushtetuese dhe degëve të tjera të së drejtës publike dhe private, të drejtës penale, civile, administrative, financiare, të drejtës së punës etj., ekziston një lidhje e caktuar. Ajo shihet në rend të parë në faktin se parimet dhe çështjet fundamentale të këtyre degëve të së drejtës gjenden të përcaktuara në kushtetutë. Për këtë arsye, kushtetuta konsiderohet si burim i së drejtës i degëve të tjera të së drejtës.

Me definimin e burimeve të së drejtës, jepet përgjigje në dy pyetje: e para: kush krijon të drejtën kushtetuese; dhe, e dyta, ku gjendet e drejta kushtetuese, në cilat akte? E drejta kushtetuese krijohet në rrethana të caktuara shoqërore nga ana e kushtetutëbërësit, i cili gëzon mbështetjen e forcave të caktuara shoqërore. Këto rrethana shoqërore që krijojnë të drejtën kushtetuese përfaqësojnë **momentin kushtetues**, që mund të jetë një akt i vetëm apo një proces i zgjatur. Në rastet kur momenti kushtetues përfaqëson një proces, atëherë krijimi i të drejtës kushtetuese nuk nis me një akt fillestar, por me një sërë aktesh, zakonesh e konventash (e drejta kushtetuese në **sistemin e të drejtës së përgjithshme**), që kanë përmbajtje kushtetuese. Në rastet kur momenti kushtetues përfaqëson një akt, atëherë akti themelor që krijohet në momentin kushtetues quhet kushtetutë. Kjo nuk do të thotë se materia e të drejtës kushtetuese gjendet vetëm në një akt, në kushtetutë, sepse ajo është prezent edhe në marrëveshje, zakone dhe burime të tjera të së drejtës ndërkombëtare, si dhe në ligje dhe akte nënligjore nga e drejta e brendshme. Të gjitha këto norma juridike, së bashku me normat juridike të degëve tjera të së drejtës që përmbajnë rregulla të materies kushtetuese, përbëjnë **sistemin kushtetues**. Në ambientin konkret shoqëror, sistemi kushtetues prodhon pasoja të caktuara reale. Tërësia e asaj që është e normuar me norma juridiko-kushtetuese dhe realiteti konkret kushtetues që prodhohet brenda sistemit kushtetues quhet **rend kushtetues**. Për këtë përdoret edhe shprehja **sistem politik**, ku hyjnë, krahas normave

që përmbajnë **materie kushtetuese**, edhe marrëdhëniet shoqërore në të cilat lindin (krijohen), zbatohen dhe ndryshohen ato norma. Në këtë kuptim, rendi kushtetues nuk është veçse emër tjetër për të drejtën kushtetuese reale-atë që zbatohet (implementohet). Falë praktikës që sqaron nëse norma juridike-kushtetuese është zbatuar dhe nëse është e dobishme, analiza e vlefshmërisë së rendit juridik tregon nëse ekziston nevoja për ndryshim kushtetues si dhe kahet e atij ndryshimi.

Idetë fillestare të kushtetutëbërësit, me rastin e nxjerrjes së kushtetutës së parë, zakonisht koncentrohen në bindjen dhe besimin se ajo do të jetë e mirë dhe jetëgjatë, reflekton tërësinë e marrëdhënieve shoqërore të kohës dhe ato që krijohen më pas dhe, në fund, do të ndikojë në nxitjen e zhvillimit shoqëror dhe politik të shoqërisë së organizuar në shtet. Historia juridiko-kushtetuese e shumë vendeve të botës tregon se këto synime janë tradhtuar me ndryshime të shpeshta kushtetuese. Kështu, ta zëmë, **Franca** revolucionare për katër vite ka miratuar tri kushtetuta të reja të plota: Kushtetuta monarkike e vitit 1791, Kushtetuta republikane e vitit 1793 dhe Kushtetuta e Direktoratit e vitit 1795. Ngjashëm ka qenë me ish-**Jugosllavinë**, por në një periudhë pak më të gjatë kohore, e cila ka pasur katër kushtetuta të plota të reja (1946, 1953, 1963 dhe 1974) dhe qindra amendamentime kushtetuese.

2. Kuptimi, origjina dhe natyra e kushtetutës

2.1 Kuptimi dhe origjina e kushtetutës

Që në fillim, si tentativë, kushtetuta mund të definohet si akti më i lartë juridik që rregullon dhe kufizon pushtetin shtetëror. Nga ky definim mund të veçohen disa elemente përbërëse të kuptimit të kushtetues.

Kushtetuta është akt juridik. Kjo nënkupton se kushtetuta përmban norma juridike, të cilat i definojmë si rregulla të sjelljes që mbrohen me fuqinë e shtetit. Krahas kësaj karakteristike, kushtetuta ka cilësinë e aktit politik. Në të janë të thurura e mishëruara idetë dhe ideologjia politike, pikëpamjet mbi botën, si pjesë e programit që duhet zbatuar në të tashmen dhe në të ardhmen.

Kushtetuta është akti juridik i përgjithshëm më i lartë. Në shtet ekzistojnë një numër i madh aktesh juridike, që formojnë sistemin juridik, në mesin e të cilëve ekziston një hierarki sipas fuqisë së tyre juridike. Në renditjen e akteve sipas fuqisë së tyre juridike, kushtetuta zë vendin më të lartë. Nga kjo rrjedh se krejt aktet tjera juridike kanë fuqinë më të ulët juridike se kushtetuta dhe duhet të jenë në përputhshmëri me të. Kjo rregull njihet si **parimi i kushtetutshmërisë**. Ekzistojnë rastet kur në vend, përkohësisht ose për kohë të pacaktuar, ekziston epërsia e akteve të tjera juridike, kryesisht të natyrës juridiko-ndërkombëtare, kundrejt kushtetutës së vendit. Një gjë e tillë mund të përcaktohet me kushtetutë, e cila shërben si akti juridik që i jep jetë epërsisë së përkohshme të akteve të caktuara juridiko-ndërkombëtare. I tillë, ta zëmë, ka qenë rasti me Kosovën gjatë pavarësisë së mbikëqyrur (2008-2012), kur vlente parimi i epërsisë së **Planit Ahtisari** kundrejt çdo akti tjetër juridik, përfshirë **Kushtetutën e Kosovës**, miratuar më 9 prill 2008 (hyrë në fuqi në mesin e qershorit të atij viti).[1] Njëjtë mund të thuhet edhe për statusin juridik-kushtetues të **Marrëveshjes së Dejtonit** (1995), por për kohë të pacaktuar. Kjo Marrëveshje ka sanksionuar paqen në Bosnje-Hercegovinë dhe, për një kohë të pacaktuar, ka epërsi ndaj **Kushtetutës së Bosnje-Hercegovinës**, e cila, në fakt, është pjesë e vetë Marrëveshjes dhe derivat i saj i plotë (Aneksi IV: Kushtetuta).[2]

---

1 Emri i plotë i **Planit Ahtisari** është **Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës** (26 mars 2007). Cf. tekstin e plotë të Planit në: https://reliefweb.int/report/serbia/comprehensive-proposal-kosovo-status-settlement-s200 7168a d d1 (shikuar në mars 2022).

2 Emri i plotë i **Marrëveshjes së Dejtonit** është **Marrëveshja e Përgjithshme Kuadër për Paqe në Bosnje-Hercegovinë.** Cf. për tekstin e plotë të Marrëveshjes në: **The General Framework Agreement for Peace in Bosnia and Herzegovina**. Initialled in Dayton on 21 November 1995 and signed in Paris on 14 December 1995. Në internet: https://www.osce.org/bih/126173 (shikuar në mars 2022).

Me kushtetutë kufizohet pushteti shtetëror (politik). Kjo bëhet në dy mënyra: e para, kushtetuta rregullon organizimin e pushtetit (pozitën e organeve shtetërore dhe juridiksionin e kompetencën e tyre); dhe, e dyta, promovon dhe mbron liritë dhe të drejtat e njeriut, duke ua njohur statusin e garancioneve kushtetuese që gëzojnë sanksion shtetëror me efekt të drejtpërdrejtë. Kjo nënkupton se normat kushtetuese përshkojnë (rrezatojnë) çdo pore të sistemit juridik, secilin akt juridik, qoftë i përgjithshëm apo individual. Juridiksioni dhe kompetencat kushtetuese të organeve shtetërore dhe sfera e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut përfaqësojnë kufijtë e pushtetit shtetëror. Në të njëjtën kohë, rregullat kushtetuese që kanë të bëjnë me organizimin e pushtetit dhe rolin dhe pozitën e individit në shoqëri shërbejnë si detyrime dhe si një "doracak për udhëzim" mbi atë se si dhe në cilin drejtim duhet të veprojë shteti gjatë ushtrimit të pushtetit shtetëror.

Para se kushtetuta të merr karakteristikat si më sipër, është dashur të kalohet nëpër disa procese, gjë që ka qenë një zhvillim historik i gjatë, me fillim që nga nisja e procesit të krijimit të shtetit modern (**Paqja e Vestfalisë**: 1648) deri te rrëzimi i **Napoleonit** (Napoleon Bonaparte: 1769-1821) nga pushteti dhe mbyllja e **Kongresit të Vjenës** (1815). Para kufizimit të pushtetit me kushtetutë, në shtetet evropiane ka ekzistuar pushteti i plotë i monarkëve (sundimtarëve), të cilët kanë drejtuar shtetet në bazë të **drejtës hyjnore**, në mënyrë arbitrare, pa asnjë kufizim dhe përgjegjësi të tyre para askujt. Ky pushtet, që buronte nga hyjnia, ka mund të kufizohet me kushtetutë, si akti më i lartë në shtet, me kusht që me këtë do të pajtohej monarku, me hirë apo me pahirë. Për të ardhur deri te kjo gjendje, në të cilën kushtetuta paraqet një pakt në mes të monarkut dhe shoqërisë për kufizim të pushtetit, është dashur të ndodh ndryshimi në natyrën e shtetit dhe pushtetit shtetëror. Pushteti duhet të burojë nga populli, i cili është sovrani, jo nga hyjnia apo monarku si përfaqësues i saj. Shteti konsiderohet krijesë e njeriut, jo e hyjnisë. Këto ndryshime janë kryer kryesisht përmes **revolucionit**, siç ka qenë rasti me revolucionet e fundshekullit XVIII në Amerikë dhe Francë, por edhe përmes rrugëve paqësore, siç ka qenë rasti me **kartat kushtetuese** dhe **kushtetutat evropiane** të gjysmës së parë të shek. XIX, kur disa monarkë evropianë pranuan kufizimet kushtetuese në pushtetin e tyre (Belgjika, Franca, Holanda, Italia, Polonia etj.). Kjo tregon qartë se, aktualisht, kushtetuta shërben si një dëshmi e ndryshimit të sovranitetit në të kaluarën e largët historike, kur qytetarët dhe populli bashkërisht luftuan për një ndryshim të tillë, por edhe si një garancion kushtetues për liritë dhe të drejtat e individit.

Nga tërë kjo që u tha deri këtu, mund të japim një tjetër definicion të kushtetutës, që është më i thellë dhe më i plotë se ky deri këtu. Në këtë kuptim, kushtetuta nuk është asgjë tjetër pos akti dhe ligji më i lartë dhe kryesor në vend mbi pushtetin shtetëror, organizimin dhe funksionimin e tij, me të cilin mbrohen liritë dhe të drejtat e njeriut dhe që ka formën me shkrim dhe është e kodifikuar në një tekst të vetëm, ose ekziston në formë të pakodifikuar në më shumë së në një tekst të vetëm dhe në burime të tjera të pashkruara.

Nga historia mësojmë se prejardhja e fjalës kushtetutë duhet kërkuar në Romën e lashtë, në të cilën janë nxjerrë aktet me emrin **constitutio**, që nënkupton rregullim, renditje, gjendje, përbërje (strukturë).[3] Si shprehje i atribuohet **Ciceronit** (Marcus Tullius Cicero: 106-43 p.e.s.). Këtu, në fakt, bëhet fjalë për ediktet e perandorëve romakë. Ato vetëm pjesërisht kanë pasur përmbajtje kushtetuese (**materia constitutionis**), krahasuar me kushtetutat bashkëkohore.[4]

Në **Anglinë** mesjetare, vendin me jetëgjatësinë kontinuele më të madhe në zhvillimin e konstitucionalizmit, përkundër që nuk posedon një kushtetutë të kodifikuar, janë miratuar akte që janë konsideruar ligje të rëndësishme. Kështu, në vitin 1164 janë miratuar **Kushtetutat e Klarendonit** ("Constitutions of Clarendon"), me të cilat janë normuar privilegjet kishtare dhe kompetencat e gjyqeve fetare

[3] Carlo Lavagna, *Istituzioni di diritto publico*. *Volume primo* (Unione Tipografico-Editrice Torinese: Torino, 1970), fq. 197-198.
[4] Ibid., fq. 19; Cf. edhe Donato Giannotti, *Republica Fiorentina* (Droz: Genève, 1990.Florence: 1990) fq. 42.

(në gjithsejtë 16 nene). Aktet tjera kushtetuese nuk e kanë pasur emrin kushtetutë, siç është rasti, ta zëmë me **Kartën e Madhe të Lirive** ("Magna Carta Libertatum": 1215), me të cilën është kufizuar pushteti i monarkut, apo **Aktet mbi Supremacinë** ("Acts of Supremacy") të vitit 1559, me të cilat është krijuar **Kisha Anglikane** (si kishë nacionale angleze). Në **Francë**, vendi që nuk e ka aq të gjatë përvojën me konstitucionalizmin, por të pasur dhe të trazuar, aktet mesjetare juridike nuk e kanë mbajtur emrin kushtetutë, por **edikt,** një ligj themelor mbretëror. Të këtij lloji janë, të zëmë, **Edikti i Nantes** ("Edict of Nantes") i vitit 1598, me të cilën iu njohën të drejtat fetare hugenotëve (protestantëve kalvinist), **Edikti i Fontanëblës** ("Edict of Fontainebleau"), me të cilin protestantëve iu morën prapa liritë e fesë dhe besimit që kishin gëzuar me Ediktin e Nantës të vitit 1598. Në të gjitha rastet, sikundër vërehet, bëhet fjalë për **rregullim parcial të materies kushtetuese**, vetëm të disa prej segmenteve të saj.[5]

E vetmja kushtetutë e shkruar angleze, që në fakt merret si kushtetuta e parë e shkruar e botës moderne, nuk është quajtur kushtetutë por **Instrumenti i Qeverisjes** ("Instrument of Governement"). Është krijuar në vitin 1653 dhe në 10 nene përmbledhë dispozitat mbi ndarjen trepalëshe të pushtetit dhe të drejtat zgjedhore. Emërtim të njëjtë me këtë, pra si **Instrumenti i Qeverisjes**, e hasim në Suedi dhe është pjesa më e vjetër e kushtetutës së pakodifikuar të këtij vendi. Në Gjermani, kushtetuta quhet **Ligji Themelor** ("LTH"), i miratuar në vitin 1949, dhe shërben si një kushtetutë e kodifikuar dhe përmbledhëse. Me këtë vëmë në dukje se nuk ka rëndësi emri por fakti nëse kodifikon ose jo materien kushtetuese. Mbi bazën e kësaj cilësie dallojnë të drejtat kushtetuese kontinentale dhe të drejtat kushtetuese të sistemit të së drejtës së përgjithshme ("common law"): në rastin e parë, ato janë kryesisht të kodifikuara në një tekst të vetëm, që maksimalisht përfshinë materien ekzistuese kushtetuese, kurse në të dytin, kjo materie gjendet e shkapërderdhur dhe e pakodifikuar nëpër burime të ndryshme të kësaj dege të së drejtës publike.

Sot, fjala kushtetutë shërben si një emërtim gjerësisht i përqafuar, me të cilin shënohet akti më i lartë juridik në vend. Në secilin vend ekziston një kushtetutë, qoftë ai vend demokratik ose jodemokratik, regjim i lirë apo diktatorial. Në këtë kuptim mund të thuhet se kushtetuta është një akt "teknik" që zë vendin më të lartë në sistemin juridik. Prapa emrit kushtetutë, megjithatë, fshihet një domethënie më e madhe. Që nga kohët e kushtetutave të para liberale kjo fjalë ka pasur konotacion të simbolit të lirisë, ka qenë parakusht për ekzistimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe regjimit demokratik. Në këtë mënyrë, nga shek. XIX e deri në ditët tona, fjala **kushtetutë** barazohet me ekzistimin e lirisë politike.

Në fund duhet thënë disa fjalë për përdorimin e këtij termi në **gjuhën shqipe**. Aktualisht, sikundër dihet, në gjuhën shqipe përdoret fjala **kushtetutë** dhe, si e tillë, është e rrënjosur në diskursin profesional dhe laik dhe përdoret për të treguar aktin më të lartë të vendit. Si nocion gjuhësor, megjithatë, nuk përputhet me fjalën latine **constitutio**: kuptimisht qëndron shumë larg prej tij. Kjo nuk ka qenë çdo herë kështu! Edhe në gjuhën shqipe, për termin kushtetutë, dikur është përdorur fjala e njëjtë me origjinë latine, përkatësisht fjala **konstitucion**. Një gjë e tillë reflektohet në librat e parë mbi të drejtën kushtetuese, të shkruara në gjuhën shqipe. Kështu, në librin e parë mbi të drejtën kushtetuese në gjuhën shqipe, me autor **Kristo Floqi**, për kushtetutë përdoret shprehja "konstitucje", kurse për të drejtën kushtetuese si degë e së drejtës pozitive përdoret shprehja "E drejta Themelore" ose "E drejta Konstitucionare".[6] Për shtetin dhe qeverinë, autori përdor cilësorin "konstitucjonare", që shënon formën e regjimit politik, të qeverisë dhe të vetë shtetit.[7] Më një fjalë, autori këtu nuk e bënë dallimin e kushtetutës si akt më i lartë i shtetit, si akt në të cilin bazohet puna e organeve shtetërore dhe që

[5] Dieter Grimm, "Types of Constitutions". Në Michel *Rosenfeld* and András *Sajó* (eds.)., *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law* (Oxford University Press: Oxford, 2012) fq. 98-132 në fq. 99-100.

[6] Kristo Floqi, *E DREJTA THEMELORE OSE KONSTITUCJONARE (HUKUKI- ESASIJE)* (Shtypshkronja Franciskane: Shkodër, 1920), seksioni i parë "KËNDUESVE TË NDERSHËM", si dhe fq. 9-11.

[7] Ibid., seksioni i parë "KËNDUESVE TË NDERSHËM" dhe fq. 12-16.

shërben si bazë juridike e regjimit politik dhe shtetëror, dhe të drejtës kushtetuese si degë e sistemit juridik pozitiv. Për të gjitha këto kuptime, autori përdor fjalën ”Konstitucjon” apo ”Ligj themelor”, për të treguar dhe përshkruar, në të njëjtën kohë, gjërat si më sipër, përkatësisht për të treguar shtetin dhe shoqërinë, aktin juridik më të lartë në vend dhe qeverinë si personifikim i regjimit politik-juridik.[8] Në mënyrë shumë të ngjashme, duke përdorur terma të njëjtë, flasin edhe juristët tjerë të kohës që kanë shkruar për kushtetutën dhe të drejtën kushtetuese.[9]

Edhe **politologët** shqiptarë të kohës bëjnë të njëjtën gjë. Libri i parë me trajtesë nga shkencat politike në kuptimin e sotëm të fjalës, ka përdorur termin kushtetutë dhe konstitucionalizëm, si derivat i kushtetutës së shkruar dhe si ideologji mbi kushtetutën, në mënyrë dhe me kuptim të njëjtë me juristët e sipërcekur.[10] Ky dyzim i të drejtës kushtetuese dhe i shkencave politike në diskursin shqiptar mbi kushtetutën dhe të drejtën kushtetuese, ka qenë i njëjtë edhe në universin kulturor kushtetues evropian, ku **e drejta kushtetuese dhe institucionet politike** kanë qenë prerogativë studimi i juristëve dhe politologëve në të njëjtën kohë. E thënë me fjalë të tjera, trajtimi i autorëve shqiptarë i të drejtës kushtetuese dhe i kushtetutës në këtë kohë ka përfshirë dimensione të theksuara të shkencave politike, krahas trajtimit juridiko-dogmatik të tyre. Kjo gjendje ka zgjatur deri në vitet ‘70-të të shekullit të kaluar.[11]

Kjo qasje ka ndryshuar pas Luftës së Dytë Botërore. Në **Shqipëri**, me instalimin e komunizmit, vjen deri të përligjësimi i termit **kushtetutë**, u mor vesh me një përmbajtje dhe kuptim krejtësisht të ndryshëm nga kuptimi dhe përmbajtja që ka pasur në vendet e demokracive kushtetuese të proveniencës liberale perëndimore.[12] Po ashtu, në trojet shqiptare në ish-**Jugosllavi** nis përdorimi i fjalës **kushtetutë** dhe e **drejtë kushtetuese**, me kuptim të njëjtë si në shtetin shqiptar dhe krejt vendet ish-komuniste. Në trojet shqiptare nën ish-**Jugosllavi**, ndërkaq, ky njëjtësim i fjalës kushtetutë dhe e drejtë kushtetuese ka ardhur si rezultat i ndikimit të literaturës serbe, e cila është përdorur në **Universitetin e Prishtinës**, në dekadat e para pas themelimit në vitin 1969/1970.[13]

2.2. Natyra e kushtetutës

Ekzistojnë dy natyra (pamje) të kushtetutës: **natyra (pamja) juridike** dhe **natyra (pamja) politike**. E para tregon se kemi të bëjmë me një rregull juridike, kurse e dyta e bënë të mundur që në kushtetutë të shohim një akt me karakter ideologjiko-politik dhe programatiko-deklarativ.

---

8 Kristo Floqi, *E DREJTA THEMELORE OSE KONSTITUCJONARE (HUKUKI- ESASIJE)* (Shtypshkronja Franciskane: Shkodër, 1920), seksioni i parë ”KËNDUESVE TË NDERSHËM”, fq. 12-16.

9 Stavro Vinjau, *E DREJTA KONSTITUCIONALE* (SHTYPSHKRONJA “Nikaj”: Tiranë, 1923), “Parathënie“ dhe fq. 3-8 (këto janë ligjërata të autorizuara, të botuara si libër); K. Tasi, *THEORI E LIGJËS SË LIGJËVE* (Ismail Mal Osmani, Botonjës: Tiranë, 1944), vetëm seksioni “Hyrje“ (ky libër flet për kodet civile, kurse për të drejtën kushtetuese flet vetëm në kontekstin e hyrjeve apo parathënieve të kodeve civile dhe tregtare shqiptare, që ishin miratuar në vitin 1928 *përnjëherë* me **Statutin Themeltar të Mbretërisë Shqiptare**; meqë ky libër është shkruar në kohën e **Luftës së Dytë Botërore**, kur **Mbretëria Shqiptare** nuk ka ekzistuar, sepse kurora i’u qe dorëzuar **Shtëpisë së Savojës**, Perandorit **Viktor Emanueli III**, atëherë autori vetëm në fillim flet për teorinë e “ligjës së ligjeve“, me kuptim kushtetutën; më pas, i tërë libri flet për kategoritë e ligjeve, mënyrën e nxjerrjes, ndryshimin dhe plotësimin dhe hyrjen e tyre në fuqi, për kolizionin e ligjeve dhe botimin e tyre në Gazetë Zyrtare; shkurt, ky autor diskuton çështje kushtetuese duke iu referuar normës më të lartë në vend, që gjendej në atë kohë e shënuar në hyrje të **Kodit Civil** dhe **Kodit Tregtar të Mbretërisë Shqiptare**, atëherë akoma në fuqi, që kishin qenë baza themelore juridike për nxjerrjen e tyre po atë vit që ishte njxerr **Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare**).

10 P. Vinçenc Prenushi, *NDËR LAMIJE TË DEMOKRACISË SË VËRTETË* (Shtypshkronja Franciskane: Shkodër, 1922) (autori në këtë libër flet për rolin dhe kontributin civilizues që ka luajtur katolicizmi në **Evropë** dhe më gjerë, duke u fokusuar në **Shqipëri** në mënyrë krahasimore; përgjatë tërë tekstit, autori përdor shprehje si më sipër të juristëve të kohës, duke e cilësuar kushtetutën dhe konstitucionalizmin si të arritura të kulturës fetare katolike).

11 Slim Laghmani, “Droit constitutionnel et Science politique Essentiellement a partir du cas français”. Në Michel Troper; Dominique Chagnollaud (eds.), *Traité international de droit constitutionnel*- Tome 1 (Traités Dalloz: Paris, 2012), fq145-179 në fq. 155-160, 167-177.

12 Libri i parë mbi të drejtën kushtetuese në **Shqipëri**, pas rënies së vendit nën sundimin komunist, është botuar në vitin 1963. Cf. Dhimo M. Dhima, *E DREJTA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË* (Fakulteti Juridik i Universitetit Shtetëror të Tiranës: Tiranë, 1963).

13 Jovan Gjorgjeviq, *E DREJTA KUSHTETUESE* (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i KSAK: Prishtinë, 1972).

Kushtetuta ka natyrë juridike sepse, **inter alia**, përmban norma juridike (rregulla të sjelljes që mbrohen me forcën e dhunës fizike të shtetit), që janë burim i të drejtës kushtetuese dhe i degëve të tjera të së drejtës; normat juridiko-kushtetuese mund të zbatohen drejtpërdrejt në zgjidhjen e një rasti apo mosmarrëveshjeje konkrete (përmes sjelljes së akteve individuale juridike të bazuara në kushtetutës, siç është, bie fjala, aktgjykimi); në bazë të normës juridiko-kushtetuese miratohen aktet tjera të përgjithshme juridike, siç janë ligjet dhe aktet tjera nënligjore. Përveç këtyre cilësive, zbatimi i drejtpërdrejtë i normave kushtetuese nënkupton edhe që liritë dhe të drejtat e garantuara kushtetuese mbrohen para gjykatës së rregullt dhe gjykatës kushtetuese. Kjo do të thotë, thënë me fjalë të tjera, që liritë dhe të drejtat e garantuara me kushtetutë vihen në jetë përmes gjyqësorit të rregullt dhe gjyqësisë kushtetuese. Kjo është kështu për shkak se kushtetuta, si akt me natyrë juridike, ka fuqinë më të lartë në krejt sistemin juridik, ashtu që krejt aktet juridike duhet të jenë në harmoni (pajtim) me të (**parimi i kushtetutshmërisë**). Kjo nuk do të thotë se në mes të akteve të tjera juridike nuk ekziston hierarkia. Këtu bëhet fjalë për hierarkinë vetëm sa i përket kushtetutës dhe marrëdhënies së saj me aktet tjera. Të gjitha aktet juridike jetojnë në hierarki, gjë që shpreh fizionominë e tërësisë apo rrethit të mbyllur të sistemit juridik marrë si tërësi, siç do të thoshte **Hans Kelsen** (Hans Kelsen: 1881-1973).[14]

Sa i përket **natyrës politike** të kushtetutës, ajo shihet si një nga cilësitë e saj themelore për shkaqe si vijon: së pari, kushtetuta përmban parime e rregulla që reflektojnë ideologjinë dominante, të cilat, për dallim nga normat juridike, nuk gëzojnë mbrojtjen e dhunshme shtetërore (nuk janë të goditshme me mjete juridike me qëllim të mbrojtjes së tyre), për shkak se kanë karakter deklarativ; së dyti, ideologjia dhe programi politik nuk janë të zbatueshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë, ashtu që për vënien e tyre në jetë nevojitet nxjerrja e ligjeve; së treti, kushtetuta në kuptimin politik përfaqëson mishërim i përmbledhur i të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes. Ideologjia e kushtetutës pjesërisht mbështetet në të kaluarën, zbatohet në të tashmen, kurse shërben si udhërrëfyes për zhvillim në të ardhmen. Dimensioni i fundit, në fakt, përfaqëson aspektin programatik të kushtetutës, sepse shpërfaqë vizonin dhe misionin e programuar të kushtetutëbërësit për shoqërinë.

Përveç si më sipër, natyra politike e kushtetutës ngërthen në vete pikëpamje teorike dhe filozofike të teoricienëve të ndryshëm mbi shoqërinë dhe shtetin. Kjo vërehet që nga frymëzimet teorike të kushtetutave të para të fundshekullit XVIII në Amerikë dhe Francë: Kushtetuta e SHBA ka qenë e ndikuar fuqishëm nga idetë e **Xhon Llokut** (John Locke: 1632-1704), kurse dokumentet e para kushtetuese franceze, në rend të parë **Deklarata për të Drejtat e Liritë e Njeriut dhe Qytetarit** (1789), kanë qenë thellësisht të ndikuara nga **Zhan Zhak Ruso** (Jean-Jacques Rousseau: 1712-1778) dhe idetë e tij mbi **vullnetin e përgjithshëm** ("**volonté générale**") dhe popullin e pagabueshëm. Manifestimi i pikëpamjeve të ndryshme teorike dhe filozofike, në tekstin kushtetues marrin trajta të ndryshme, në të cilat vlerësohen të mirat shoqërore, siç janë, ta zëmë, liria, barazia, pronësia, të cilat, së bashku, bëhen vlerat më të larta të shoqërisë për faktin se sanksionohen (mbrohen) me kushtetutë, kurse vetë kushtetuta, në këtë mënyrë, fiton një cilësi të caktuar ideologjike (**konstitucionalizmi liberal**). Kjo

[14] Idenë e sistemit koherent juridik, **Hans Kelsen** e ka bazuar në teorinë e tij mbi vlefshmërinë, sipas së cilës norma bazike (**grundnorma**) shërben si autorizuese e vlefshmërisë së krejt sistemit juridik. Ky sistem, që bazohet në normën bazike apo **grundnormën**, ka strukturë hierarkike, të mbyllur në formë piramide. Në ndërkohë që norma bazike shërben si autorizuese e vlefshmërisë apo jetës së normave të tjera, vetë ajo presupozohet dhe nuk ka krijues. Ajo thjeshtë merret si e mirëqenë dhe përfaqëson "kushtetutën e parë historikisht shikuar" (H. Kelsen), e cila u jep jetë normave të tjera të krejt sistemit juridik.Këtë teori, **H. Kelsen** e ka përpunuar gjerësisht në veprën e tij monumentale "Teoria e Pastër e së Drejtës", e cila për herë të parë u botua në vitin 1934 në gjuhën gjermane, kurse në gjuhën angleze vetëm pas **Luftës së Dytë Botërore**. Cf. Hans Kelsen, *The Pure Theory of Law* (California University Press: Berkeley and Los Angeles, 1967); Për komente të teorisë dhe të vetë librit, cf. më shumë në M. P. GOLDING, "KELSEN AND THE CONCEPT OF 'LEGAL SYSTEM", *Archiv für Rechts- und Sozialphilosophie* Vol. 47 (1961) fq. 355-386; Michael S. Green, "Hans Kelsen and the Logic of Legal Systems" *Alabama Law Review* Vol. 54 No. 2 (Winter 2003) fq. 365-413; Reut Yael Paz, "Kelsen's *Pure Theory of Law* as 'a Hole in Time'". *Monde (s)* Vol. 1 No. 7 (Maj 2015) fq. 75-94.

është e kundërt me kushtetutat e vendeve ish-komuniste apo me diktaturat tjera të proveniencës së ideologjive të ekstremit të djathtë: në dy situatat, ideologjia e kushtetutës, që sanksionohet me të, ngrit në vlera sublime kushtetuese jetën dhe shëndetin e shtetit dhe strukturave koorporativiste që i shërbejnë atij, duke reduktuar vlerën e njeriut dhe të mirave shoqërore që duhet të shërbejnë për të, në një asgjë që duhet të jetë në shërbim të një interesi abstrakt kolektiv që definohet në mënyrë nebuloze (me dy kuptime) në kushtetutë.

Në vijim si më sipër, me kushtetutë definohet regjimi politik-kushtetues, ashtu që përcaktohen vlerat e tij më të spikatura që gëzojnë mbrojtjen juridike: "shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik, dhe i pandashëm (Kosova)"; "republikë parlamentare, shtet unitar dhe i pandashëm: (Shqipëria)"; "shtet sovran, i pavarur, demokratik dhe social"; "shtet sovran dhe i pavarur me regjim republikan të qeverisjes, shtet civil, demokratik, ekologjik, shtet i drejtësisë sociale dhe i bazuar në sundimin e së drejtës"; "shtet i popullit serb dhe i qytetarëve të saj, i bazuar në sundimin e së drejtës dhe drejtësinë sociale, parimet e demokracisë qytetare, liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, dhe përkatësinë ndaj parimeve dhe vlerave evropiane"; "shtet i pavarur, demokratik dhe juridik (Hungaria); "shtet sovran dhe demokratik që udhëhiqet nga sundimi i ligjit, në të cilin nuk është i obligueshëm asnjë ideologji apo besim fetar (Sllovakia); "shtet socialist i punëtorëve dhe fshatarëve" (ish-BRSS dhe vendet tjera ish-komuniste) etj.

Pa marrë parasysh natyrën politike dhe ideologjinë që përqafon, për kushtetutën ka rëndësi të madhe që të jetë reale dhe e realizueshme, pra mos të jetë fiktive dhe joreale, e parealizueshme. Kjo do të thotë, thënë me fjalë të tjera, që dispozitat kushtetuese duhet të jenë realisht ekzistuese, jo themel nominal i sistemit juridik, të zbatohen dhe të reflektohen në ligje e akte të tjera që zbatohen në praktikë. Në vendet me kushtetutë të ideologjisë liberale, ku nuk është zhvilluar mjaftueshëm demokracia, rendi politik dhe socio-ekonomik, ku ekziston një kulturë politike e nivelit të ulët, mund të vije deri të mosrealizimi i duhur i saj. Kjo sepse janë faktorë të tjerë, që ruajnë prezencën e tyre jashtë normave kushtetuese, që ndikojnë në realizimin e kushtetutës si tërësi, përkundër faktit që ajo i takon proveniencës së kushtetutave liberale-demokratike.

2.3. Kushtetuta në kuptimin material dhe formal

Mund të identifikohen disa kuptime themelore të kushtetutës. I pari është kuptimi **normativ** i saj, që ka dy dimensione: **material** dhe **formal**. I dyti është kuptimi **politik** i kushtetutës, kurse i treti kuptimi **sociologjik**. Sikundër shihet, në vartësi të fokusit të analizës, prodhohen edhe këto tri kuptime themelore të kushtetutës.

Në **kuptimin normativ**, kushtetuta përfshinë një tërësi të normave që kanë përmbajtje kushtetuese dhe fuqi më të lartë juridike në kuadër të akteve juridike në vend. Mund të dallohet dimensioni **material** dhe dimensioni **formal** i kuptimit **normativ** të kushtetutës. Kuptimi normativ i kushtetutës, nganjëherë emërtohet edhe si kuptimi **juridik** i kushtetutës, gjë që është e njëjta gjë: këtu fokusi është në normën juridike-kushtetuese, që shpërfaq dy dimensione-formal dhe material. Të gjitha shtetet, të mëdha ose të vogla, të varfra apo të pasura, demokratike dhe jodemokratike, kanë një kushtetutë në kuptimin material. Një kushtetutë e tillë përfshinë normat që i përkasin materies kushtetuese (**materia constitutionis**), të cilat normojnë pushtetin shtetëror dhe liritë e të drejtat e njeriut. Këto norma formojnë kushtetutën në kuptimin material, pa marrë parasysh formën në të cilën shprehen (me shkrim apo gojë, akte të kodifikuara apo të pakodifikuara, kushtetutë apo dispozitë tjetër).

Sa i përket **materies kushtetuese**, ajo mund të grupohet në tri çështje të ngjashme. Dispozitat lidhur me shtetin janë **rregullat mbi rregullimin e shtetit**: parimi i sovranitetit shtetëror, ndarja e pushtetit, forma e qeverisjes, forma e rregullimit shtetëror. Materia kushtetuese që rregullon të drejtën përf-

shinë **regjimin e krijimit të së drejtës**, përkatësisht si krijohen normat juridike (kush i krijon, sipas cilës procedurë dhe formë). Në fund vijnë çështjet lidhur me shoqërinë dhe përfshijnë **rregullat që normojnë marrëdhëniet më të rëndësishme në shoqëri**-liritë dhe të drejtat e njeriut, mekanizmat për mbrojtjen e tyre, marrëdhëniet ekonomike dhe shoqërore.

Pjesa dërrmuese e shteteve kanë kushtetutë në kuptimin formal (nuk e kanë, ta zëmë, Britania e Madhe, Zelanda e Re, Izraeli etj.). Kushtetuta në **kuptimin formal** ka dy cilësi themelore: një, përmbajtja e saj çdo herë konsiderohet se është materie kushtetuese; dhe, dy, ajo çdo herë ka formën e caktuar - e miraton organi kushtetutëbërës sipas procedurës së përcaktuar, në formën me shkrim. Kjo nënkupton se kushtetuta është akti më i lartë juridik në vend në raport me krejt aktet tjera juridike. Në rastin më të shpeshtë, **kodifikimi i kushtetutës** në një tekst të vetëm paraqet cilësinë e kushtetutës në kuptimin formal. Amendamentet e mëpastajme janë pjesë integrale e kushtetutës së kodifikuar.

Në kushtetutën e shkruar, normat kushtetuese zakonisht ndahen në nene dhe njësi më të mëdha të sistemimit, përkatësisht në paragrafë, krerë dhe pjesë. Kushtetuta e shkruar më së shpeshti është një akt juridik i kodifikuar, shumë rrallë shfaqet në disa akte juridike. Si raste kur kushtetuta nuk gjendet në një tekst të vetëm, në një akt të vetëm juridik, mund të përmenden **Kushtetuta e Francës** e vitit 1875, që ka qenë e përbërë nga tri akte juridike, **Kushtetuta e Suedisë** (1974), aktualisht në fuqi me disa ndryshime, që përbëhet nga pesë akte kushtetuese etj.

Procedura e veçantë e miratimit dhe ndryshimit (amendamentimit) të kushtetutës është cilësi e kushtetutës në kuptimin formal. Kushtetutën e miraton organi kushtetutëbërës, që mund të jetë një parlament në përbërje të zakonshme apo një organ i posaçëm-kuvend kushtetues. Në procedurën e krijimit të kushtetutës mund të marrin pjesë edhe qytetarët dhe populli, përmes referendumit. Procedura e kushtetutëbërjes zakonisht është më e komplikuar se ligjvënia: subjektet që nisin procedurën e miratimit dhe amendamentimit të kushtetutës nuk janë të njëjtë, ka më shumë faza krahasuar me ligjvënien, kërkohet një shumicë më e kualifikuar krahasuar me ligjvënien. Vetëm përjashtimisht kushtetuta miratohet dhe amendamentohet sipas procedurës së njëjtë me atë të ligjvënies. Nga të gjitha rregullat juridike, vetëm kushtetuta përcakton për vetëveten procedurën e miratimit dhe ndryshimit (amendamentimit).

Fuqia më e lartë juridike është cilësi tjetër e kushtetutës në kuptimin formal. Kjo rrjedhë nga procedura e kushtetutëbërjes, që përfshinë organin që miraton kushtetutën, procedurën e komplikuar të krijimit dhe vetë rëndësinë e materies kushtetuese që normohet me të. Fuqia më e lartë juridike nënkupton se ligjet dhe krejt aktet juridike më të ulëta duhet të jenë në përputhshmëri me kushtetutën. Kushtetutshmëria e ligjeve dhe akteve të tjera juridike, sipas rregullit, vlerësohet nga gjykatat kushtetuese apo gjykatat e jurisdiksionit të përgjithshëm, në ndërkohë që ekzistojnë vende që nuk e njohin fare kontrollin e kushtetutshmërisë përmes mekanizmave të gjyqësisë kushtetuese apo gjyqësorit të rregullt (Finlanda, Holanda, Suedia, Norvegjia, Zvicra etj.).

Një cilësi tjetër e kuptimit të kushtetutës në **kuptimin formal** është se ajo nuk ngërthen në vetëvete krejt **materien kushtetuese**, por vetëm pjesën më kryesore dhe më të rëndësishme që ka të bëjë me shtetin dhe shoqërinë e dhënë. Ajo materie që gjendet aty, megjithatë, konsiderohet se është materie kushtetuese e kodifikuar. Këtu futen rregullat themelore mbi **bashkësinë politike**, siç janë: rregullimi shtetëror (monarki apo republikë, shtet i thjeshtë apo i përbërë, shtet qytetar apo shtet nacional) dhe **pozita e individit në shtet** (bartës i sovranitetit, subjekt i së drejtës së sovranitetit, si dhe liritë dhe detyrimet që realisht i posedon). Këto rregulla shumë shpesh paraqiten në formë të **parimeve kushtetuese**.

Pjesë shumë e rëndësishme e kushtetutës në kuptimin formal janë **liritë dhe të drejtat e njeriut**. Me rregullimin e tyre kushtetues, ato fitojnë cilësinë e garancioneve më të fuqishme juridike dhe bëhen kufizuese të pushtetit shtetëror e definues të fizionomisë së tij. Sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut, shteti nuk guxon ta cenojë, ndërkohë që ngushtimi i saj mund të bëhet vetëm duke ndjekur kushtet dhe procedurat e paracaktuara kushtetuese. Paralel me liritë dhe të drejtat e njeriut, pjesë e kushtetutës në kuptimin formal janë edhe **normat mbi rregullimin e pushtetit** që ndërtohet mbi **parimin e ndarjes dhe balancimit të tij**. Ky parim përfaqëson cilësinë definuese të karakterit demokratik të shtetit, në të cilin qeverisin qytetarët përmes përfaqësuesve të zgjedhur. Bazuar në norma kushtetuese, organet e pushtetit kufizohen dhe kontrollohen reciprokisht, në ndërkohë që janë të kufizuar edhe me të drejtat dhe vullnetin politik të qytetarëve.

Nëse i krahasojmë kuptimet e kushtetutës në kuptimin formal dhe material, gjëja e parë që bie në sy është se kuptimi i fundit i kushtetutës është shumë më i gjerë, për shkak se përfshinë tërë **materien kushtetuese**, e cila, për shkak të vëllimit të madh, nuk mund të përfshihet në një akt të vetëm të shkruar. Për këtë arsye, kushtetuta në kuptimin material nuk e përjashton ekzistimin e kushtetutës në kuptimin material. Kështu, ta zëmë, **Kushtetuta e Kosovës**, kur është nxjerrur ka pasur 162 nene, kurse me amendamentet e mëpastajme numri i dispozitave dhe vëllimi i tyre është shtuar dukshëm.[15] Ngjashëm është situata edhe me kushtetutat e vendeve përreth Kosovës: kur është miratuar, **Kushtetuta e Shqipërisë** (**KShq**) ka pasur 183 nene, kurse sot ka më shumë dispozita;[16] **Kushtetuta e Maqedonisë së Veriut**, kur është miratuar më 17 nëntor 1991 ka pasur gjithsejtë 134 nene, kurse sot ka një amendamentim të konsiderueshëm;[17] **Kushtetuta e Malit të Zi**, në kohën e miratimit më 19 tetor 2007 ka pasur 158 nene;[18] dhe, së fundi, **Kushtetuta e Serbisë** ka pasur 206 nene kur është miratuar më datën 30 shtator 2006.[19] Kjo përvojë e Kosovës dhe vendeve fqinje paraqet vazhdimësi të standardit në vendet tjera: Kushtetuta e Francës e vitit 1958 ka pasur vetëm 92 nene, sot ka më shumë dispozita; **Kushtetuta e Danimarkës** e vitit 1953 ka pasur 89 nene, sot ka shumë më shumë dispozita aktive; **Kushtetuta e Italisë** e vitit 1947, si teksti më vëllimor, ka

---

15 **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**, aktualisht në fuqi, e miratuar me 9 prill 2008, ka pësuar disa amendamentime, amendamentet I- XXII (**Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës** nr. 25 dt. 7 shtator 2012) amendamentin XXIII (**Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës** nr. 7 dt. 26 mars 2013) dhe amendamentin XXIV (**Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës** nr. 20 dt. 5 gusht 2015).

16 **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, aktualisht në fuqi, përmbahet në Ligjin nr. 8417, datë 22.11.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 të Kuvendit Popullor, miratuar me referendum më 22.11.1998 dhe shpallur me dekretin nr. 2260, datë 28.11.1998 të Presidentit të Republikës, **Rexhep Mejdani**. Është ndryshuar me **ligjet e karakterit kushtetues** për sa vijon: ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007, ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008, ligjin nr. 88/2012, datë 18.09.2012, ligjin nr. 137/2015, datë 17.12.2015, ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, dhe ligjin nr. 115/2020, datë 30.07.2020.

17 Amendamentet I dhe II të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, të cilat i miratoi Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, në seancën e mbajtur më 6 janar 1992; Amendamenti III i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, të cilin e miratoi Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, ne seancën e mbajtur më datë 1 korrik 1998; Amendamentet IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII, XIII, XIV, XV, XVI, XVII dhe XVIII të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë të cilat i miratoi Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, në seancën e mbajtur më 16 nëntor 2001; Amendamenti XIX i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, të cilin e miratoi Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, në seancën e mbajtur më datë 26 dhjetor 2003; Amendamentet XX, XXI, XXII, XXIII, XXIV, XXV, XXVI, XXVII, XXVIII, XXIX dhe XXX të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, të cilat Kuvendi i Republikës së Maqedonisë i miratoi në seancën e mbajtur më datë 7 dhjetor 2005; Amendamenti XXXI i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, të cilin Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e miratoi në seancën e mbajtur më datë 9 janar 2009; Amendamenti XXXII i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë që Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e miratoi në seancën e mbajtur më 12 prill 2011; Amendamentet XXXIII, XXXIV, XXXV dhe XXXVI të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, të cilat Kuvendi i Republikës së Maqedonisë i miratoi në seancën e mbajtur më 11 janar 2019.

18 Amendamentet I – XVI të datës 31 korrik 2013.

19 Në **Serbi** ekziston kategoria e ligjeve kushtetuese për zbatimin e kushtetutës dhe amendamenteve të saj. Cf. **Ustavni zakon za sprovođenje Akta o promeni Ustava Republike Srbije.** Ligji Kushtetues me të cilin janë bërë amendamentimet e fundit është botuar në "Službeni glasnik RS", nr. 115/2021, datë 30 nëntor 2021, datë kur ka hyrë në fuqi ky ligj, me të cilin zbatohen amendamentet I – XXIX në **Kushtetutën e Serbisë**.

395 nene, që janë më shumë se kur është miratuar. Për dallim nga kushtetuta në kuptimin material, kushtetuta në kuptimin formal paraqet një dispozitë apo rregullativë të plotë nga aspekti **nomoteknik**, përmbajtja e së cilës mund të aplikohet dhe qaset me lehtësi (gjendet e kodifikuar në një ose disa tekste juridike). Kushtetuta në kuptimin material ndryshohet në mënyrë të vazhdueshme, pandërprerë, me ndryshim të dispozitave që rregullojnë **materien kushtetuese**, kurse kushtetuta në kuptimin formal ndryshohet relativisht rrallë dhe sipas një procedure të paracaktuar. Për këtë arsye, një vend që ka kushtetutë formale domosdo ka edhe kushtetutë materiale, por jo edhe anasjelltas: vendet që kanë vetëm kushtetutë materiale, nuk kanë kushtetutë në kuptimin formal, pra nuk kanë një tekst unik kryesor që kodifikon në mënyrë maksimalisht gjithëpërfshirëse marrëdhëniet kushtetuese.

Kuptimi **politik** i kushtetutës e vë theksin në kualitetin politik të pushtetit, në rolin mbrojtës dhe në organizimin e tij. Në këtë kuptim, kushtetuta ekziston kur pamundësohet arbitrariteti, subjektiviteti dhe shpërdorimi i pushtetit nga ana a bartësve të tij, ashtu që ekziston ndarja dhe balancimi i pushtetit, kurse te liritë dhe të drejtat e garantuara mbrohen në mënyrë efektive. Ky kuptim lidhet me emrin e **Karl Lovenshtajn** (Karl Loewenstein: 1891-1973) dhe **Karl Fridrih** (**Carl Joachim Friedrich**: 1901-1984), dy konstitucionlistëve eminentë perëndimorë.

Elementet më të plota të kuptimit politik të kushtetutës i ka dhënë **K. Lovenstein**.[20] Ato elemente janë, **inter alia**, si vijon:

- ndarja e pushtetit, përfshirë federalizmin dhe autonominë lokale;
- mekanizmat e paracaktuar për bashkëpunim në mes të pushteteve qendrore me qëllim të shmangies së bllokadave dhe ngecjeve në ushtrimin e pushtetit (balancimi i pushteteve);
- ekzistimi i mënyrave dhe mekanizmave racionalë për kryerjen e ndryshimeve të duhura kushtetuese me qëllim të përshtatjes ndaj realitetit shoqëror dhe me qëllim të ikjes nga revolucionet si mënyrë ndryshimi;
- njohja e lirive dhe të drejtave individuale dhe krijimi i mekanizmave për mbrojtjen e tyre, me qëllim të sigurimit dhe krijimit të hapësirës për vetëvendosjen individuale kundrejt shtetit etj.

Sikundër shihet, këto elemente përbëjnë esencën e konstitucionalizmit liberal perëndimor, për çka ka qenë i njohur ky autor.

Shumë i afërt konceptualisht me **K. Lovenstein** ka qenë një bashkëkohës i tij, **Karl Fridrih.** Konsiderohet se një vend ka kushtetutë në kuptimin politik, sipas **K. Fridrih**, nëse në të ekziston kufizimi efektiv i pushtetit shtetëror. Ky autor e sheh kushtetutën në kuptimin politik si një proces politik i kufizimit efektiv të pushtetit shtetëror/politik. Kjo nuk ndodhë vetëm pse në një vend ekziston një kushtetutë e shkruar, ngaqë ajo nuk është garancion i kushtetutës si proces politik i kufizimit efektiv të pushtetit shtetëror. Kjo është arsyeja pse ky autor flet për kushtetutat e konstitucionalizuara dhe kushtetutat e pa konstitucionalizuara. Të parat ekzistojnë atëherë kur ekziston ndarja funksionale e pushtetit, sigurimi dhe mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut, federalizmi dhe ndarja territoriale e pushtetit, kontrolli gjyqësor i administratës dhe kështu me radhë.[21] Procesi i kufizimit efektiv të

[20] Karl Loewenstein*, Political Reconstruction* (Macmillan Co.: New York, 1948); Karl Loewenstein*, Political Power and the Governmental Process* (University of Chicago Press: Chicago, 1957); Karl Loewenstein, "Constitutions and Constitutional Law in the West and in the East". *The Indian Journal of Political Science* Vol. 30, No. 3 (July-September 1969), fq. 203-248.

[21] C. J. Friedrich, "*Political Reconstruction*. Karl Loewenstein". *The Journal of Modern History* Vol. 20 No. 3 (Sep., 1943) fq. 251-252; Carl J. Friedrich*, Constitutional Government and Democracy: Theory and Practice in Europe and America* (Ginn and Company: Boston, 1950); Paul Sigmund, "Carl Friedrich's Contribution to the Theory of Constitutionalism – Comparative Government". *Nomos* Vol. 20, CONSTITUTIONALISM (1979), fq. 32-43; Johnathan O'Neill, "Carl J. Friedrich's Legacy: Understanding Constitutionalism as a Political System". *The European Legacy* Vol. 14 Issue 3 (2019) fq. 283-300.

pushtetit shtetëror shprehet pak a shumë, gjithnjë sipas këtij autori, me shprehjet si ”pushteti ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor”, “të drejtat e njësive federale”, “procedurat e përcaktuara me ligj”, “liria e shprehjes dhe e shtypit”, “liria e fesë” etj. etj. Këto janë shprehje që shërbejnë si simbol i një rendi kushtetues ku kushtetuta paraqitet si një forcë politike.

Së fundi, kuptimi **sociologjik** i kushtetutës, ka lindur në përpjekjet për të sqaruar shpërputhjen në mes të anës normative dhe reale të kushtetutës së shkruar. Si i tillë, ky kuptim fokusohet vetëm në forcat reale shoqërore si forcë motorike dhe si përcaktuese të rendit kushtetues, jo në normat kushtetuese nga kushtetuta formale dhe kushtetuta materiale.[22] Këto forca dhe këto marrëdhënie shihen si përcaktuese të formave juridike-kushtetuese, të cilat nuk janë asgjë tjetër pos një superstrukturë juridiko-politike e shoqërisë që bazohet në forcat prodhuese dhe marrëdhëniet në prodhim, që janë të pabarabarta dhe eksploatuese.[23]

Formën më radikale të **kuptimit sociologjik të kushtetutës** e ka përfaqësuar **F. Lasal** (Ferdinand Lassalle: 1825-1864), i cili edhe është ndërtues i këtij kuptimi. Sipas këtij kuptimi, kushtetutat nuk janë asgjë pos instrumente që fshehin strukturat e pushtetit dhe të pabarazisë ashtu që pushteti i pastër mbizotëron dhe përbën kushtetutën, asnjëherë normat juridiko-kushtetuese. Pikëpamjet e tij mbi kushtetutën, nga këndvështrimi i luftës së klasave, ky autor i ka shprehur më 16 prill 1862, në një fjalim të tij në **Berlin**, të titulluar ”Mbi esencën e kushtetutave”.[24] Aty ka shprehur bindjen se kushtetutat nuk janë asgjë tjetër pos shprehje e raportit të forcave në një shoqëri. Çdo ndryshim i këtij raporti sjell ndryshimin e **kushtetutës formale**. Tërësia e raportit të forcave ndërmjet klasave, të cilat ky autor i quan **kushtetutë reale**, përcaktojnë dhe definojnë **kushtetutën formale**. Kjo e dyta, **kushtetuta formale**, nuk është veçse reflektim i këtij raporti. Si shembull për këtë, autori e merr skllavërinë dhe Kushtetutën e SHBA-ve: **heqja e skllavërisë** nga Kushtetuta u bë, sipas tij, vetëm atëherë kur Veriu nënshtroi Jugun dhe imponoi abrogimin e skllavërisë si institucion amerikan.

3. Mbi dy koncepte të rëndësishme dhe pashmangësisht të lidhura me kushtetutën: “grundnorma” dhe pushteti konstituiv

Ai pushtet që krijon kushtetutën e parë, **grundnormën**, është pushtet konstituiv origjiner dhe nuk është i lidhur për asnjë kufizim juridik. Kjo është kësisoj për shkak se pushteti konstituiv origjiner, në të njëjtën kohë është edhe pushtet sovran dhe cilësi e sovranitetit në kuptimin modern të fjalës. Ky pushtet sovran, përgjatë historisë së lindjes së kushtetutave moderne, është shfaqur në tri forma kryesore, që janë lidhur për **popullin**, **individin** dhe për dytë marrë së bashku-**popullin dhe individin**. Në aspektin doktrinar, ndërkaq, këto forma njihen si **forma demokratike**, **monokratike** dhe **mikse** e manifestimit të pushtetit që prodhon kushtetutën e parë apo **grundnormën**.[25] Emërues i përbashkët i tri formave është se manifestimi i tyre çdo herë ndodhë në vakum dhe jashtë kontekstit juridik ekzistues apo, siç e thotë një autor francez, manifestimi në fjalë paraqet **hipotekën e një hipoteze**. Kjo shprehje përdoret për të treguar se çdo herë kur lind një **grundnormë** ekziston një barrë apo hipotekë për të arsyetuar se pse dhe si ka lindur ajo. Për **Hans Kelsen**, ta zëmë, ekzistimi i **grundnormës** presupozohet, kurse për **Karl Shmit** (Carl Schmitt: 1888-1985), ekzistenca e saj provohet përmes faktit se paraqet një vendim ekzistencial të një populli me të cilin definohet statusi i tij politik, përf-

[22] Costantino Mortati, *La Costitutzione in senso materiale* (Giuffrè Editore: Milano, 1940); Cf. edhe Temistocle Martines, *Diritto Costituzionale* (Giuffrè Editore: Milano, 2011) fq. 11-12.

[23] Marco Goldoni, “Introduction to the material study of global constitutional law”. *Global Constitutionalism* Vol. 8 No. 1 (2019) fq. 71–93 në fq. 72-73.

[24] Cf. më shumë për këtë në Ferdinand Lassalle, “On the Essence of Constitutions” (*Speech Delivered in Berlin, April 16, 1862*). *Fourth International* Vol. 3 No. 1 (January 1942) fq. 25 – 31. Në internet: https://www.marxists.org/history/etol/newspape/fi/vol03/no01/lassalle.htm#top (shikuar më 27 qershor 2020); Jovan Đorđević, *Ustavno pravo*, fq.18; Marco Goldoni, “Introduction to the material study of global constitutional law”, fq. 72-73.

[25] Marcel Prélot & Jean Boulouis, *Institutions politiques et droit constitutionnel*. Onzième édition (Précis Dalloz: Paris, 1990), fq. 220.

shirë definimin e formën juridike të një statusi të tillë të definuar politikisht.[26]

Me pushtet sovran këtu nuk nënkuptohet vetëm pushteti që rrjedhë nga populli, që në literaturë quhet **shumësia** ("la multitude"), por edhe ai pushtet konstituiv origjiner që ushtrohet nga titullarët tjerë legjitim (monarku, kuvendi kushtetues, si dhe referendumet e format tjera të shprehjes së drejtpërdrejt të vullnetit qytetar).[27] Ushtrimi i autorizimit që buron nga pushteti konstituiv origjiner i institucionalizuar mund të humb nga ana e titullarëve të tij në aktin e parë të krijimit të **grundnormës**. Në literaturë janë dhënë format historike të humbjes së autorizimit fillestar për ushtrim të pushtetit konstituiv në mënyrë institucionale, të cilat janë për sa vijon: krijimi i shtetit të ri, transformimi i regjimit, abrogimi i rendit pararendës kushtetues; qeveritë faktike dhe kalimi në një regjim të rregullt të së drejtës.[28] Në të gjitha këto raste, ushtrimi i pushtetit konstituiv origjiner bëhet në vakum juridik.

Ka qenë konkurrenca në mes të pushtetit sovran të monarkut dhe pushtetit sovran të popullit, konteksti në të cilin ka lindur dhe është farkëtuar pushtetit konstituiv origjiner. Në kohën e restaurimit të dinastisë **Burbone** në Francë, për herë të parë hasim në shfaqjen e pushtetit konstituiv origjiner që ushtrohet, jo nga **shumësia**, por nga monarku burbon, përmes dhënies popullit francez të **Kartës Kushtetuese** (1814), e cila u bë model edhe në disa vende të tjera evropiane përgjatë shekullit XIX. Me këtë hap u ndërtua koncepti i **sovranitetit të kushtetutës**: vullneti kolektiv i popullit, i shprehur përmes mbretit dhe parlamentit francez, u tha se buronin nga Karta dhe jashtë saj ai vullnet nuk ka asnjë vlerë. Kështu e ka shprehur **Aleks de Tokvil** (Alexis Charles Henri Clérel, comte de Tocqueville: 1805-1869), duke iu referuar Kartës si më sipër, kur ka thënë se jashtë kushtetutës pushteti nuk është asgjë.[29]

Asnjë shqyrtim mbi kushtetutën, lindjen, kuptimin dhe zhvillimin e saj, nuk do të ishte i kompletuar pa kuptimin siç duhet të kategorisë juridiko-kushtetuese dhe politiko-filozofike të njohur si **pushtet konstituiv**. Në literaturën krahasimtare të së drejtës kushtetuese më shumë njihet me shprehjen franceze **pouvoir constituant**. Në gjuhën shqipe aktualisht përkthehet si pushtet kushtetutëbërës dhe rrjedh nga kopijmi i fjalës në gjuhët sllave, kryesisht serbe, "ustavotvorna vlast".[30] Në gjuhën shqipe, megjithatë, shprehja "pushtet kushtetutëbërës" nuk e shpreh në tërë-

[26] Oliver Gohin, *Droit constituionnel* (LexisNexis: Paris, 2013) fq. 158.

[27] Marcel Prélot & Jean Boulouis, *Institutions politiques et droit constitutionnel*, fq. 220 & (autorët theksojnë se idenë e **shumësisë** e kanë inicuar filozofi dhe teologu jezuit spanjoll, **Francisko Suarez**, Francisco Suárez**:** 1548-1617, dhe teologu, prifti jezuit dhe shkrimtari italian, **Robert Belarmin**, Robert Bellarmin: 1542-162; sipas autorëve, këta dy teolog e filozof na mësojnë se cdo pushtet që nuk bartet apo nuk kalon te institucionet dhe organet e sistemit ngelet në duart të shumësisë apo popullit; po ashtu, shumësia e ushtron këtë pushtet cdoherë kur humb titullari fillestar në të cilin është bartur ushtrimi i pushtetit konstituiv derivativ); Ngjashëm edhe Carl Schmitt, *Constitutional Theory,* Trans and ed. by Jeffrey Seitzer (Duke University Press: Durham and London, 2008), fq. 77 (para ekzistimit të normës kushtetuese çdo herë ekziston një vendim konkret politik i pushtetit konstituiv; ai vendim mund të jetë i popullit, në një demokraci të vërtetë, apo i monarkut, në një monarki, na thotë autori).

[28] Marcel Prélot & Jean Boulouis, *Institutions politiques et droit constitutionnel*, 196-206.

[29] Cituar sipas Carl Schmitt, *Constitutional Theory*, fq. 63.

[30] Në **Shqipëri** ka hyrë nën ndikimin e teorisë dhe praktikës kushtetuese sovjetike, gjë që shihet nga libri i parë shqip mbi të drejtën kushtetuese komuniste, ku autori përdor shprehjen "pushtet kushtetutëbërës" dhe shprehjen "pushtet konstituiv" në mënyrë të njëpasnjëshme, si njërën ashtu tjetrën. Më vonë, shprehja **pushtet kushtetutëbërës** është stabilizuar ashtu që sot, si e tillë, përdoret nga të gjithë autorët shqiptar mbi të drejtën kushtetuese. Cf. Dhimo M. Dhima, *E DREJTA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË*. Për autorët e mëvonëshëm, cf. Luan Omari & Aurela Anastasi, *E drejta kushtetuese*. Botimi i dytë (ABC: Tiranë 2010).
Në territorin ish-jugosllav, shprehja pushtet kushtetutëbërës është përdorur në shqip nga ana e atyre që kanë përkthyer autorët më me ndikim serb të së drejtës kushtetues. Cf. Jovan Gjorgjeviq, *E drejta kushtetuese* (Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i KSAK: Prishtinë, 1972) (përkthyes i këtij libri ka qenë profesori i mirënjohur i të drejtës kushtetuese, në fakt **doajeni i të drejtës kushtetuese ndër shqiptarët në ish-Jugosllavi**, Prof. Dr. **Kurtesh Salihu**, tani i ndjerë). Më vonë, në librat e autorëve shqiptarë të territorit ish-jugosllav, kjo terminologji është stabilizuar ashtu që sot përdoret gjithandej. Në fakt, nuk kemi hasur asnjë autor që përdor shprehjen origjinale me origjinë franceze **pouvoir constituant** (pushtet konstituiv). Cf. Kurtesh Salihu, *E drejta kushtetuese*. Botimi i katërt (Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës: Prishtinë, 2004) (të gjithë autorët tjerë që kanë shkruar pas tij kanë kopijuar këtë qasje dhe e kanë marrë si të mirëqenë, pa asnjë referim në literaturën krahasimtare mbi origjinën dhe kuptimin e shprehjes "pushtet konstituiv"; për këtë arsye ne nuk i citojmë autorët tjerë sepse nuk kanë dhënë ndonjë qasje inovative, pos që kanë përsëritur atë që e thotë Prof. Kurtesh Salihu në këtë libër, i

si dhe siç duhet esencën e kuptimit të pushtetit konstituiv, lindjes, zhvillimit dhe llojeve të tij. Termi **pushtet konstituiv** reflekton një fenomen tjetër shoqëror që shkon përtej kushtetutëbërjes formale dhe përfshin edhe trajtën që nuk është kushtetutëbërje. Kjo e fundit, kushtetutëbërja, asnjëherë nuk mund të absorbojë në gjirin e vet krejt trajtat e pushtetit konstituiv. Shprehja shqipe "pushtet kushtetutëbërës", në thelb i përshtatet vetëm trajtës **pouvoir constituant dérivé** *(*pushtetin konstituiv derivativ*),* që nuk nënkupton pushtetin konstituiv origjiner.

Përdorimi i termit "kushtetutëbërje" për dy trajtat e pushtetit konstituiv është pasojë e ndikimit të literaturës sllave, në të cilën zakonisht nuk bëhet dallimi në mes të pushtetit konstituiv origjiner dhe pushtetit konstituiv derivativ (ky i fundit jo rrallë cilësohet si pushtet amendamentues). Kjo është arsyeja pse sqarojmë dy kuptimet themelore të pushtetit konstituiv, gjithnjë në dritën e faktit bazik se ai paraqet katalizatorin e kushtetutës në të gjitha kuptimet e saj. Në këtë kuptim, përdorimi nga ana e jonë i termit "kushtetutëbërje" apo "pushtet kushtetutëbërës" përdoret ekskluzivisht për atë që ushtrohet sipas procedurave dhe kushteve të përcaktuara kushtetuese të një rendi ekzistues kushtetues, i njohur ndryshe edhe si **pushtet amendamentues**, **pushtetin konstituiv derivativ, pushtet për reformë kushtetuese** etj.

Në teorinë dhe praktikën kushtetuese, fenomeni shoqëror tanimë i njohur si **pouvoir constituant**, është shumë i komplikuar, aq shumë sa krahasohet me procesin e lindjes së universit, të planetit tokë dhe njeriut bashkë me të, si një **big bang** juridik-kushtetues.[31] I parë nga ky prizëm, "big bang-u kushtetues" shfaqet në formë të ngjarjeve parajuridike, si p.sh.: revolucionet, grushtshtetet e suksesshme, secesionet, okupimet etj., të cilat shërbejnë si pikënisje për çdo diskutim teorik dhe praktik lidhur me rendin juridik-kushtetues që formohet.[32] Është shumë më shumë se kushtetuta në kuptimin e saj juridik, politik dhe sociologjik, përkatësisht më shumë se kuptimi i kushtetutës në të gjitha trajtat e tyre kuptimore dhe përmbajtësore. Vetëm njëri prej tri kuptimeve të kushtetutës të diskutuara më herët, kuptimi juridik-formal apo kushtetuta formale mund të kornizohet përmes normave juridike. Pushteti që prodhon kushtetutën në kuptimin juridiko-formal quhet **pushtet konstituiv derivativ** dhe është pasojë logjike dhe krejt e natyrshme e hierarkisë së normave juridike që ekziston në këtë kuptim të kushtetutës. Ky hierarkizim nuk mund të ndodhë dhe nuk ka kuptim te kuptimet tjera të kushtetutës, në veçanti jo te kuptimi politik dhe sociologjik i kushtetutës. Kjo është kështu për shkak se, nëse vazhdojmë me teorinë e gjenezës së universit, në kuptimet politike dhe sociologjike të kushtetutës nuk ekziston një "big bang" që "shpërthen" me qëllim të ndriçimit dhe rregullimit të jetës dhe veprimtarisë së njeriut politik aristotelian.

Në literaturë me të drejtë është vërejtur se dilema në mes të kushtetutës si një **big bang**, sajuar nga **Xhorxh Vedel** (Georges Vedel: 1910-2002), dhe kushtetutës si piramidë, sajuar nga **Hans Kelsen**, në thelb është e njëjtë sepse lidhet për fenomenin që lind dhe krijohet në ambientin etimologjikisht meta-juridik, pra bëhet fjalë për diçka që lind jashtë një konteksti juridik të paracaktuar. Se kjo është kështu, qartë shihet nga botëkuptimi i pushtetit konstituiv i vetë krijuesit të këtij termi **Abati i Sijes** (Emmanuel-Joseph Sieyès: 1748-1836), i cili nuk ka bërë dallimin në mes të dy trajtave të sotme me të cilat asocohet ky fenomen-pushteti konstituiv origjiner dhe pushtetit konstituiv derivativ. Ky dallim ka lindur shumë më vonë, në fillim të shekullit XIX, kur është përdorur për herë të parë doktrinarisht.[33]

cili, në të njëjtën kohë, paraqet librin e parë gjithëpërfshirës shqip mbi të drejtën kushtetuese ndër shqiptarët që kanë jetuar nën sundimin ish-jugosllav).

31 Henry Roussillon, "Le *Big Bang* et la pyramide!". Në Henry Roussillon, Xavier Bioy et Stephane Mouton (eds.), *Le nouveaux objets du droit constitutionnel* Presses de l'Universite des sciences sociales de Toulouse: Toulouse, 2006) fq. 11-15.

32 Zoran Oklopcic, "The Paradox of Constitutionalism: Constituent Power and Constitutional Form". *International Journal of Constitutional Law*, Volume 6, Issue 2 (April 2008), fq 358–370 në fq. 358-359.

33 Joel Colón- Ríos, *Constituent Power and the Law* (Oxford University Press: Oxford, 2020) fq. 19-20 dhe kapitulli 3 ("Sieyès *via* Rousseau": fq. 56-76).

Për **Abatin e Sijes**, në ndërkohë që pushteti shtetëror kufizohet me kushtetutë, mbi pushtetin e popullit nuk rëndon asnjë kufizim i tillë. Teoria i ka cilësuar këto dy kategori të pushtetit konstituiv si "dy trupat e popullit": njëri si trup që merr formën juridike të votuesit apo organit të konstituuar që quhet shtet, ndërsa tjetri si një trup i popullit që shërben si themel i krejt ngrehinës shtetërore/politike dhe i formës kushtetuese të kufizimit të pushtetit.[34] Ky i fundit, apo **pushteti konstituiv origjiner**, është pushtet sovran dhe juridikisht i pakufizuar, i takon popullit sovran që e shpreh atë me qëllim të definimit të statusit të tij konkret politik në një kohë dhe hapësirë të caktuar, dhe që mund ta tërheq dhe abrogojë, ndryshojë dhe plotësojë në çdo kohë.

4. Zhvillimi i konstitucionalizmit

Në këtë vend diskutojmë për zhvillimin e konstitucionalizmit nëpër botë, për të kaluar më pastaj në zhvillimin e konstitucionalizmit në Kosovë dhe në botën shqiptare, krejt në mënyrë telegrafike, për të dhënë një pasqyrë reale të momenteve kryesore kushtetuese në botën perëndimore, të cilën e synon Kosova dhe vendet përreth saj.

Asnjëherë nuk mund të kuptohen kushtetutat e Kosovës dhe të vendeve përreth, si instrumente formalo-juridike mbi të cilat mbështetet organizimi dhe funksionimi i pushtetit, roli e pozita e individit në shoqëri, pa pasur një pasqyrë adekuate mbi lindjen dhe zhvillimin e konstitucionalizmit në botën e qytetëruar perëndimore. Kjo nënkupton pasjen parasysh të momenteve kryesore të historisë kushtetuese të vendeve të perëndimit.

Aktualisht supozohet se ekzistojnë mbi 500 kushtetuta, nëse në këtë kategori futen edhe kushtetutat e njësive federale të shteteve sovrane dhe të pavarura.

4.1. Zhvillimi i konstitucionalizmit në botë

Kufizimet formale të pushtetit, të bazuara në dokumente të rëndësisë kushtetuese, kanë nisur shumë më herët se fundi i shek. XVIII (sikundër u pa me herët, ato datojnë nga Mesjeta e mesme, me **Kushtetutat e Klarendonit** dhe **Kartën e Madhe të Lirive**, deri në modernitetin e hershëm, me **Instrumentin e Qeverisjes**). Këto kufizime kanë qenë fragmentare. Vetëm me nxjerrjen e kushtetutave të para, për herë të parë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, vjen deri te kodifikimi i marrëdhënieve të pushtetit, që kryhet me nxjerrjen e kushtetutave formale, që paraqesin pikën nisëse për trajtim integral të zhvillimit të konstitucionalizmit bashkëkohor. Bëhet fjalë për nxjerrjen e akteve më të larta juridike, kushtetutave të para të shkruara, në fillim në **Amerikë** e më pas në **Francë**, me të cilat për herë të parë në mënyrë gjithëpërfshirëse vjen deri te kodifikimi i marrëdhënieve të pushtetit, përfshirë këtu definimin dhe përcaktimin e

[34] Martin Loughlin, *Foundations of Public Law* (Oxford University Press: Oxford, 2010) fq. 231-232. Në literaturë shkohet aq larg sa thuhet se ky dallim në mes të pushtetit orgjiner dhe pushtetit konstituiv derivativ ka lindur në debatet e Anglisë së shek. XVII dhe lidhen me **Interregnum**. Sipas kësaj, kjo periudhë fillon me ekzekutimin e **Mbretit *Çarls* I** (King Charles I: 1600-1649) më 30 janar 1649 dhe mbyllet me ardhjen e djalit të tij **Mbretit *Çarls*** II (King Charles II: 1630-1685) në Londër më 20 maj 1660, datë që shënon fillimin e **Restaurimit.** Gjatë **Interregnumit** kanë ekzistuar forma të ndryshme të qeverisjes republikane në **Angli**, gjë që nënkupton se ka pasur një mbretëri deri në fillimin e **Restaurimit**.
Debati lidhur me këto dy llojet e pushtetit konstituiv është dominuar nga ministri anglikan, rektori **George Lawson** (1598-1678). Sipas tij, **sovraniteti real** i takon komunitetit dhe është superior kundrejt **sovraniteit personal**, që është pushteti i **komonuelltit të konstituar** (krijuar/organizuar). Apo, thënë ndryshe, gjithnjë sipas **G. Lawson** pushteti madhor (real) definohet si pushteti për të modeluar shtetin dhe ky pushtet konstituiv (origjiner) i takon komunitetit apo, në gjuhën e **Abe Sijes**, kombit (sot popullit). Ky dallim në mes të këtyre dy pushteteve në **Anglinë** e kësaj kohe ka pasur për qëllim kufizimin e pushtetit legjislativ (pushtetit të Parlamentit). Një gjë e tillë bazohej në arsyetimin sipas të cilit anëtarët e Parlamentit konsideroheshin thjeshtë si titullar të një **sovraniteti personal**. Kjo cilësi e tyre (si përfaqësues të një të treti që quhet popull) ka bërë që ata, si anëtarë të Parlamentit, mos të kenë mundësi për të ndryshuar apo rrënuar kauzën që përbën vetë **raison d' etre** të ekzistencës së këtij organi përfaqësues. Në të njëjtën kohë, sipas këtij arsyetimi, anëtarët e organit përfaqësues nuk mund të përzihen në ligjet fundamentale të kushtetutës së vendit, të cilat, nëse pushojnë së ekzistuari, po ashtu pushton së ekzistuari vetë organi përfaqësues – Parlamenti. Cf. Pasquale Pasquino, "Constitution et pouvoir constituant: le double corps du peuple ". Në Jean Salem, Vincent Denis **and** Pierre-Yves Quiviger (eds.) *FIGURES DE SIEYÈS. Philosophie* (Éditions de la Sorbonne: Paris, 2008) fq. 13-23.

rolit dhe pozitës së individit në shoqëri.

Një kohë të gjatë e drejta kushtetuese, si degë e së drejtës pozitive, është cilësuar si "E drejtë shtetërore", sepse, që nga fundi i shekullit XVI (**Revolucioni i lavdishëm anglez** i vitit 1688) e deri në fund të shekullit XVIII (**revolucionet amerikane dhe franceze**), periudhë përgjatë së cilës kur në mënyrë graduale u krijua shteti modern, asnjëherë nuk është diskutuar mundësia që objekt i rregullimit kushtetues të jenë liritë dhe të drejtat njerëzore. Kjo shpjegon pse tekstet e ndryshme kushtetuese në këtë periudhë, kanë pasur të bëjnë kryesisht me organizimin, formën dhe mënyrën e ushtrimit të pushtetit (autoritetit) publik. Vetëm nga fundi i shekullit XVIII nis evoluimi i konsiderueshëm i të drejtës kushtetuese, në atë mënyrë që objekt rregullimi fillojnë të bëhen edhe liritë dhe të drejtat njerëzore, pra jo vetëm organizimi i shtetit dhe i pushtetit, përkatësisht ndarja e kompetencave në mes të organeve shtetërore (sistemi politik). Kjo fazë, e cila nis me revolucionet në **Amerikë** e **Francë** respektivisht, ndryshe njihet edhe si faza e **shtetit kushtetues**, së cilës i ka parapri faza pararendëse e **shtetit absolut**.[35]

Më pastaj, në shekullin në vijim, në gjysmën e parë të shek. XIX, vjen deri te përhapja e kushtetutave të shkruara edhe në vendet tjera të botës, evropiane dhe latino-amerikane, kurse në gjysmën tjetër të shekullit të njëjtë, kushtetuta bëhet standard edhe në formacionet politike perandorake.

Fillimisht, kushtetutën e parë e ka miratuar **Shteti Virgjinia** më 29 qershor 1776, kolonia e parë që u shkëput nga Britania e Madhe, në mesin e trembëdhjetë kolonive të para që më pas formuan SHBA-të si shtet sovran dhe i pavarur. Kjo kushtetutë ka pasur ndikim vendimtar në **Kushtetutën e SHBA-së**, që u miratua më 17 shtator 1787, aktualisht në fuqi dhe njëkohësisht kushtetuta më e vjetër në botë me vlefshmëri të pandërprerë që nga koha e krijimit. Një shtet tjetër, mikroshteti **San Marino**, i enklavizuar në tërësi nga **Italia**, posedon dokumentin kushtetues më të vjetër në botë, por që nuk është kushtetutë në kuptimin formal të një teksti të vetëm, që në mënyrë gjithëpërfshirëse kodifikon marrëdhëniet e pushtetit. Quhet **statut** dhe është i përbërë prej gjashtë librave, të shkruara në latinisht, që normojnë segmente të ndryshme të organizimit dhe funksionimit të pushtetit politik në këtë vend të vogël.[36]

Franca revolucionare, për më pak se pesë vjet, ka prodhuar tri kushtetuta (1791-1795). Të katërtën e ka miratuar në vitin 1799. Këto kushtetuta në mënyra të ndryshme kanë normuar rolin dhe pozitën kushtetuese të organeve shtetërore (monarki kushtetuese, sistemi kuvendor apo i konventës, direktorati dhe sistemi i konsulatit). Si të tilla, kushtetutat në fjalë shënojnë nisjen e një zhvillimi të frytshëm dhe dinamik të konstitucionalizmit francez dhe më gjërë. Këto kushtetuta dhe ato që janë miratuar më vonë në Francë kanë pasur ndikim të madh në kushtetutat e më pastajme, të miratuara në Evropë. Kështu, **Kushtetuta e vitit 1791**, që themeloi monarkinë kushtetuese franceze ka ndikuar në **Kushtetutën e Spanjës** (1812) dhe Norvegjisë (1814, në fuqi sot e kësaj dite); një kushtetutë tjetër franceze, **Kushtetuta e Montanjarit** (1793), që instaloi sistemin e konventës apo kuvendeve, pati ndikim të fuqishëm në **Kushtetutën e Rusisë Sovjetike** të vitit 1918 (dhe kushtetutat e mëspatajme komuniste që pasuan); njëjtë mund të thuhet për **Kushtetutën e Direktoratit** të vitit 1795, që pat ndikim në **Kushtetutën e Zvicrës** (1848, 1874 dhe 1999); së fundi, **Kushtetuta e vitit 1799** (sistemi i konsullatit), ndikoi në konstitucionalizmin me shef kolektiv të shtetit (sot ky ekziston në **Kushtetutën e Bosnje-Hercegovinës** të vitit 1995, e cila, siç u tha, është pjesë e **Marrëveshjes së Dejtonit** të atij viti).

---

35 Cf. Marc Uyttendaele, *Trente leçons de droit constitutionnel*, (Bruxelles: Brylant, 2014), fq. 50.

36 Në fakt, emri i saktë është **Statutet** (Statuti), të shkruara nga kapiteni bashkëregjent **Kamilo Bonelli** (Camillo Bonelli), prandaj edhe nuk mund të thuhet se ky vend ka kushtetutë në kuptimin formal të një teksti të vetëm që kodifikon marrëdhëniet e pushtetit në mënyrë gjithëpërfshirëse. Cf. më shumë në William Miller, "The Republic of San Marino". *The American Historical Review,* Vol. 6 No. 4 (July 1901), fq. 633-649; Jorri C. Duursma, Jorri Carolina Duursma, *Fragmentation and the International Relations of Micro-states: Self-determination and Statehood* (Cambridge University Press: Cambridge, 1996) fq. 211-214.

Në fazën e parë të zhvillimit të konstitucionalizmit të shkruar nëpër botë, edhe vendet tjera, krahas Amerikës dhe Francës, miratojnë kushtetutat e tyre, të kodifikuara dhe të pakodifikuara. **Konfederatat e Polonisë** dhe **Lituanisë** këtë e bënë në vitin 1791, **Suedia** në vitin 1809, **Blegjika** në vitin 1831, kurse vendet latino-amerikane si vijon: **Haiti** në vitin 1805, **Venezuela** në vitin 1819, **Argjentina** në vitin 1819, **Brazili** në vitin 1824. Në të gjitha këto raste, kryesisht bëhet fjalë për konstitucionalizëm të proveniencës liberale, që themelon monarkitë kushtetuese evropiane dhe republikat në **Amerikën Latine**.

Pas revolucioneve evropiane të viteve 1848-1849, në periudhën që njihet si **koha e konstitucionalizmit liberal-demokratik**, miratohen kushtetuta të reja, kurse konstitucionalizmi i shkruar zgjerohet edhe në kontinentet tjera. Si kushtetuta të rëndësishme të kësaj kohe mund të përmenden: kushtetutat e Francës të viteve 1848 dhe 1875, kushtetuta e parë e **Danimarkës** (1849, aktualisht në fuqi), **Spanjës** (1869), **Kanadas**ë (1867, aktualisht në fuqi), **Australisë** (1900, aktualisht në fuqi), **Rusisë cariste** (1906), republikës së parë aziatike – **Filipineve** (1899). Në këtë kohë janë miratuar edhe kushtetuta që nuk kanë qenë liberale-demokratike, përkatësisht kushtetutat e perandorive austro-hungareze (1867), gjermane (1871), otomane (1876) dhe japoneze (1889).

Periudha në mes të dy luftërave botërore karakterizohet me zhvillimin e mëtutjeshëm të konstitucionalizmit liberalo-demokratik, së bashku me dukurinë e parlamentarizmit të "racionalizuar" në shtetet e reja evropiane: **Finlanda** (1919), **Austria** dhe **Çekosllovakia** (1920), **Polonia** (1921), **Irlanda** (1922). I njëjti trend shfaqet edhe në shtetet ekzistuese, si: **Gjermania** (1919), **Greqia** (1927), Spanja (1931). Në këtë kohë vjen deri të miratimi i kushtetutave të para socialiste: **Kushtetuta e RSFSR** apo **Rusisë Sovjetike** (1918), **Kushtetuta e Mongolisë** (1921). E kundërt me konstitucionalizmin liberal-demokratik, konstitucionalizmi autoritar nis e shtrin rrënjë në vendet si vijon: **Portugalia** (1933), **Austria** (1934), **Polonia** (1935), **Mbretëria Serbo-Kroato-Sllovene** (1931), si dhe në vendet ku akoma formalisht ekziston në fuqi një kushtetutë liberale-demokratike, krahas ndërtimit të një rendi autoritar (Italia, Gjermania dhe Spanja).

Pas **Luftës së Dytë Botërore**, zhvillimi i konstitucionalizmit merr disa drejtime, në mesin e të cilëve mund të veçohen dy sosh: kahu i **konstitucionalizmit klasik liberal-demokratik** i vendeve kapitaliste dhe kahu i **konstitucionalizmit socialist**. Në kuadër të grupit të parë, shtetet e mëdha të Evropës miratojnë kushtetutat e tyre të reja: Franca (1946 dhe 1958), Italia (1947), Gjermania (1949). Paralel me këto zhvillime, bazuar në modelin sovjetik të Kushtetutës së ish-BRSS-së të vitit 1936, në Evropë përhapet konstitucionalizmi socialist, në themelet e të cilit nuk janë pronësia private dhe sistemi shumëpartiak, por pronësia shtetërore dhe monizmi partiak, përkundër asaj që disa vende ish-komuniste kishin pranuar në kushtetutat e tyre nominalisht këto vlera liberale (pronësinë private dhe sistemin shumëpartiak). Të tilla kanë qenë rastet e kushtetutave të ish-Jugosllavisë (1946), Bullgarisë (1947), Çekosllovakisë, Rumanisë (1948), Hungarisë dhe ish-Republikës Demokratike të Gjermanisë (1949), të cilat, më vonë, janë zëvendësuar me kushtetuta tipike socialiste të draftuara sipas modelit sovjetik. Edhe vendet tjera socialiste jashtë Evropës miratojnë kushtetutat e tyre, të ndikuara fuqishëm nga modeli sovjetik, si: Republika Demokratike e Vietnamit (1946), Republika Demokratike e Koresë (1948), Republika Demokratike e Kinës (1954), Kuba (1974), Tanzania (1965). Konstitucionalizmi socialist në Evropë merr fund në fund të shek. XX, për të ngelur sot në një numër të vogël shtetesh (**Kina**, **Kuba**, **Koreja Veriut**, **Laosi**). Të gjitha vendet ish-komuniste, pas rrënimit të sistemit komunist, kanë përqafuar fuqishëm konstitucionalizmin liberal-perëndimor që bazohet në demokraci, sundim të ligjit, ndarje dhe baraspeshë të pushteteve dhe respektim të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve. Në këtë aspekt, kushtetutat e këtyre vendeve ngjasojnë shumë njëra me tjetrën.

Vala e **dekolonizimit**, në gjysmën e dytë të shek. XX, ka çuar në zgjerimin e konstitucionalizmit edhe në **Afrikë** dhe **Azi**. Ish-kolonitë kryesisht përqafojnë modelin e konstitucionalizmit të fuqive të tyre koloniale (Britanisë së Madhe, Belgjikës, Francës, Holandës, Portugalisë), duke rregulluar sistemin e pushtetit sipas konceptit të kushtetutave të tyre. Në një numër të vogël të ish-kolonive instalohet sistemi i përzier i konstitucionalizmit socialist dhe liberal dhe i konstitucionalizmit që ka cilësi fetare, kryesisht islamike, siç janë rastet e Algjerisë, Tunizisë, Marokut, Libisë, Egjiptit, Sirisë, Irakut, Iranit dhe Pakistanit.

4.2. Zhvillimi i konstitucionalizmit në Kosovë, botën shqiptare dhe vendet përreth

Në trojet shqiptare në **Ballkan**, në fazën e parë të lindjes së konstitucionalizmit perëndimor, në fund të shekullit XIX, krejt shekullin XIX e deri në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912, as që mund të bëhet fjalë për një zhvillim autonom të konstitucionalizmit sipas parametrave liberal të proveniencës perëndimore. Kjo për shkak se, trojet shqiptare në **Ballkan** në këtë kohë ndodheshin nën sundimin e **Perandorisë Otomane**, e cila, për herë të parë nxjerr një kushtetutë mjaft jetëshkurtër, nën urdhrat e sulltanit otoman **Abdylhamiti II** (Abdülhamid II: 1842-1918). E kemi fjalën për **Kushtetutën e Perandorisë Otomane** të vitit 1876, që u suspendua në vitin 1878, pas dy vitesh zbatimi. U restaurua sërish nga Xhonturqit (lëvizja revolucionare otomane që rrëzoi nga froni **Sulltan Abdylhamitin II** në vitin 1909). Në literaturën kushtetuese të konstitucionalistëve shqiptarë është vërejtur se përsiatja e parë teoriko-kushtetuese përgjatë vijave dhe frymës së konstitucionalizmit modern, në botën shqiptare ka ndodhur me veprën e **Sami Frashrit** "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet" (1899), ku parashihej formimi i një republike shqiptare, me parlament, qeveri, gjyqe dhe autonomi lokale, me tri universitete dhe një organ kolegjial në krye të shtetit. Institucionet politike të shtetit të ardhshëm shqiptar do të organizoheshin sipas parimit monteskian të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, me ngjyrime të forta nacionale dhe me një kryeqytet që do të quhej **Skanderbegas**.[37] Pjesërisht edhe aktet e **Lidhjes së Prizrenit** (1878) mund të cilësohen si dokumente me rëndësi kushtetuese, nisur nga fakti se në fazën e dytë, pas nisjes së përpjekjeve të dhunshme të pushtetit otoman për shtypje dhe shpartallim, kërkesat e **Lidhjes së Prizrenit** janë qartë të artikuluara, si kërkesa për liri dhe për vetadministrim sipas dokeve dhe zakoneve shqiptare, por edhe bazuar në idetë e konstitucionalizmit të kohës, që ishin përhapur në Ballkan, tanimë nën ndikimin e fuqive perëndimore. E kemi fjalën për **Programin e Lidhjes Shqiptare** të datës 15 shtator 1878, që parashikonte në pikën e pestë formimin e **Këshillit të Madh**, si organ suprem që do të ishte i trup i dal nga zgjedhjet, në ndërkohë që konfirmonte të drejtën e sovranitetit të Sulltanit që në pikën e vet të parë.[38] Programi kishte dispozita të detajuara për organizimin e brendshëm, ushtrinë dhe forcat e rendit, administratën dhe ndarjet administrative të trojeve me shumicë shqiptare (përkundër faktit që në thelb përfshinte edhe territoret e **Bosnje-Hercegovinës** së sotme dhe pjesëve të konsiderueshme të sanxhakut të **Novi Pazarit**. Nëse merren parasysh krejt këto aspekte të dokumenteve bazë të **Lidhjes së Prizrenit**, mund të thuhet se, në tërësi, ajo nuk mund të cilësohet si **Kuvend Kushtetues** për shkak se nuk kishte për qëllim formimin e shtetit të pavarur dhe sovran shqiptar, pasi që në mënyrë shprehimore theksonte mbështetjen pa rezervë për sovranitetin e **Sulltanit** dhe ruante tërësinë tokësore të Perandorisë Otomane dhe njihte supremacinë e ligjeve të **Sheriatit**.[39] Në thelb, kjo supremaci e Sheriatit si dhe mungesa e tërësishme e dispozitave mbi kufizimin e pushtetit shtetëror, dy mungesa këto themelore për kohën dhe sot e kësaj dite, bëjnë që dokumentet bazë të Lidhjes së Prizrenit të kenë vështirësi për të qenë pjesë e panteonit që matet me parametra të konstitucionalizmit të liberalizmit perëndimor.

Me shpalljen e pavarësisë së **Shqipërisë**, vjen deri te realizimi i konstitucionalizmit në botën shqiptare, por vetëm parcialisht, për shkak të shtrirjes së tij gjeografike: pjesa tjetër e trojeve shqiptare kishte ngelur nën sundimin e huaj, e privuar nga statusi i subjektit kushtetues dhe vetë e drejta për ekzistencë. E kemi fjalën për **Kushtetutën e Vidovdanit** (1921), e cila u nxor në vijim të shpalljes së **Mbretërisë Serbo-Kroato-Sllovene** më 1 dhjetor 1918, dhe **kushtetutat Greke** në fuqi në mes të dy luftërave botërore (por edhe më pas deri në ditët e sotme), të cilat mohonin në tërësi ekzistencën e kombit shqiptar. Kjo lidhet me konceptin grek të konstitucionalizmit, që mohon dhe nuk e kultivon diversitetit etnik dhe gjuhësor jogrek, që nga ditët e para të lindjes së **Greqisë** moderne. Fillimisht diskutojmë këtë vend, pastaj i kthehemi **grundnormës** së **Shqipërisë**, që lindi më 28 nëntor 1912. Kjo sepse, vetëm në këtë renditje të

---

[37] Cf. më shumë në Elmaz Sherifi, Political and Constitutional Thought Sami Frashëri *Mediterranean Journal of Social Sciences* Vol. 3 No 8 (April 2012), fq. 131-136, në fq. 134-135; Aurela Anastasi, *HISTORIA E TË DREJTËS KUSHTETUESE NË SHQIPËRI (1912-1939)* ("Dajti 2000": Tiranë 2018), fq. 5-10.

[38] **Programi i Lidhjes Shqiptare** (Prizren, 15 shtator 1878). Për tekstin e plotë, cf. Aleks Luarasi, *AKTE JURIDIKE PËR HISTORINË E SHTETIT DHE TË DREJTËS NË SHQIPËRI*. Botim i Dytë (OMBRA GVG: Tiranë, 2014) fq. 322-323.

[39] **Akti i vendimeve** (Kararname) (Prizren, 18 qershor 1878), nenet 1, 2 dhe 4. Për tekstin e plotë, cf. Ibid., fq. 309-322.

shtjellimit, që më pas kalon në trojet etnike shqiptarë nën ish-**Jugosllavi**, e cila ka qenë tërësisht e njëjtë sikur **Greqia** sa i përket konceptit të shtetit dhe identitetit shqiptar në të, lexuesi mund të ketë një pasqyrë më të qartë për gjendjen e konstitucionalizmit ndër shqiptarët në **Ballkan**.

Grekët kanë shpallur pavarësinë e tyre më 15 janar 1822,[40] duke krijuar kështu **grundnormën** e parë të një shteti që do të modelohet sipas standardeve të konstitucionalizmit modern të kohës, bazuar në sovranitetin e popullit. Kjo pavarësi u njoh me **Protokollin e Londrës** të 3 shkurtit 1830, që njohu **Greqinë** si shtet sovran dhe të pavarur.[41] Tri kushtetutat e para greke u draftuan në vazhdën e **Luftës Greke për Pavarësi**: më 1822, 1833 dhe 1827. Ato ngërthyen në dispozitat e tyre një mori tekstesh kushtetuese të kohës para-revolucionare, të cilat ishin nën ndikimin e fuqishëm të **Deklaratës Franceze për Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit** (1789) dhe kushtetutat franceze të viteve 1793 dhe 1795. Autorët e tyre kanë qenë nga diaspora e fuqishme greke dhe filohelenë evropian. Në **Revolucionin Francez**, këta hartues gjetën filozofinë e aftë për të shërbyer objektivat e përbashkëta-frymëzimin një lëvizjeje kryengritëse dhe ofrimin e bazës ideologjike të shtetit të ri. Kjo është kësisoj për shkak se, sikundër dihet, supozimi fillestar dhe premisa themelore e **Revolucionit Francez** ka qenë që kushtetuta përfaqëson garancinë më të mirë kundër arbitraritetit të pushtetit politik që nxirrte legjitimitetin e vet nga hyjnia. Mbi këtë premisë u ndërtuan kushtetutat e para greke dhe ato që erdhën më pas: historia kushtetuese greke njeh trembëdhjetë kushtetuta gjithsejtë, deri në ditën e sotme, kur është në fuqi Kushtetuta e vitit 1975 (me amendamentimet e fundit të vitit 2019).[42] Kjo nënkupton se asnjë vend nuk do të lihej për shprehje të diversitetit etnik. Fakti që u tri kushtetutat e para draftuan nën hegjemoninë e autoriteteve ruse dhe otomane, bënë që ato të prodhojnë regjime autoritare, që nuk kishin fort ndjeshmëri për asnjë lloj diversiteti, politik, etnik, gjuhësor, fetar dhe tjetër. Përkundër që proklamohej supremacia e kushtetutave, secilës prej tyre, sekularizmi dhe barazia, në praktikë këto tri kushtetuta sanksionuan epërsinë e fesë ortodokse greke dhe regjimet autoritare të prijësve kryengritës lokalë.[43] Edhe atëherë ku u shpall era e vërtetë e liberalizmit kushtetues, që karakterizohet me futjen e parimit të demokracisë, siç njihet sot me Kushtetutën e vitit 1864, që në nenin e saj 31 sanksiononte se "krejt pushtetit buron nga kombi dhe ushtrohet sipas asaj që përcakton Kushtetuta", liritë dhe të drejtat e njeriut ishin liri dhe të drejta të grekëve etnik, jo të minoriteteve të tjera që në atë kohë ishin jashtëzakonisht të theksuara në peizazhin demografik helen. Kjo u cilësua si "demokraci e kurorës", jo demokraci monarkike, sepse bazohej në sovranitetin popullor, që nuk shihte në popull askënd tjetër pos grekëve të definuar etnikisht.[44]

---

40 Për tekstin e plotë, cf. **The Greek Declaration of Independence** (1822). Declaration_of_Independence (shikuar në mars 2022).

41 **The London Protocol of 3 February 1830**. Në internet: https://kingscollections.org/exhibitions/speci alcollections/greece/british-involvement-in-the-war/london-protocol (shikuar në mars 2022).

42 Këto përbëjnë nëntë periudha kushtetuese: periudha e parë përfshinë kushtetutat e revolucionit (1821-1833); periudha e dytë përfshinë monarkinë absolute (1833-1843); periudha e tretë ngërthen monarkinë kushtetuese (1843-1862); periudha e katërt i referohet të a.q. "demokracisë së kurorës", për shkak se kushtetuta është dhuruar nga kurora (1863-1923); periudha e pestë është koha e draftimit të një kushtetute republikane, për herë të parë, 1924-1927, dhe shpalljes së republikës (1927-1935); periudha e gjashtë lidhet me restaurimin e monarkisë dhe diktaturën, nga viti 1936 deri në **Luftën e Dytë Botërore** dhe okupimin e vendit (1935-1941); periudha e shtatë ka të bëjë me pas-luftën dhe Kushtetutën e vitit 1952 (1944-1967); periudha e tetë është diktatura ushtarake, e njohur si "diktatura e kolonelëve" (1967-1974); dhe, së fundi, periudha e nëntë-restaurimi i demokracisë dhe Kushtetuta e sotme republikane e datës 11 qershor 1975. Cf. Andreas Calogeropoulos, "The Hellenic Republic". Në Lucas Prakke and Constantijin Kortmann (eds.), *Constitutional Law of 15 EU Member States* (Kluwer Legal Publishers: Deventer, The Netherlands, 2004), fq. 369-416 në fq. 369.

43 May Chehab "Philhellenism and Constitutionalism: The First Greek Constitutions". Në Martin Vöhler, Stella Alekou and Miltos Pechlivanos (eds.), *Concepts and Functions of Philhellenism. Aspects of a Transcultural Movement* (DE GRUYTER: Berlin/Boston, 2021), fq. 211- 222 në fq. 214 e tutje.

44 Edhe kushtetutat e mëvonshme parashihnin një katalog të pasur të lirive dhe të drejtave të njeriut, por që në peizazhin kushtetues grek nuk regjistronin asnjë diversitet etnik, gjuhësor, kulturor dhe tjetër (përveç diversitetit fetar): përfituesit e këtyre çdo herë përcaktoheshin sipas shtetësisë greke, që përkthehej me terma etnik, standard ky i vënë nga revolucionarët francez në fund të shekullit XVIII. Përveç kësaj, edhe për vetë grekët nuk ishte se këto garancione kushtetuese të lirive dhe të drejtave individuale kishin ndonjë efekt të madh. Kështu, ta zëmë, Kushtetuta e vitit 1952, që deri atëherë ishte më zemërgjera në sferën e garancive në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut, në praktikë zhvlerësohej nga qeveritë e dhunshme greke që nxirrnin ligje eliminues të këtyre garancioneve kushtetuese. Edhe Kushtetuta e vitit 1975 ka sanksionuar një sovranitet popullor, pa diveristet etnik, gjuhësor dhe tjetër, përveç atij fetar, duke barazuar liritë dhe të drejtat individuale me liritë dhe të drejtat individuale të atyre që janë etnikisht grek, duke shtypur kësisoj çdo identitet tjetër

Vënia në spikamë e **religjionit grek ortodoks** ngeli e rrënjosur në secilën prej kushtetutave helene deri në ditët e sotme. Kjo gjendje më së shumti erdhi në pah në mes të dy luftërave botërore: ata që ishin shqiptarë etnikë, me vendndodhje kompakte, siç ishte rajoni i **Çamërisë**, me nenin 2 të **Marrëveshjes së Lozanës** të 30 janarit 1923, u konsideruan thjeshtë si myslimanë.[45] Kjo vlente edhe për popullsinë etnike turke dhe tjetër që nuk ishte e krishterë, përveç hebrenjve që u njohën si kombësi minoritare e posaçme. Kjo gjendje uniformiteti etnik dhe fetar që u imponua, u reflektua edhe në legjislacionin dhe kushtetutat greke të kohës.[46]

Një komision që u formua pranë **Lidhjes së Kombeve** për këmbim të popullsive në mes të Greqisë dhe Turqisë, bazuar në nenin 11 të **Marrëveshjes së Lozanës**, nuk reflektonte fare faktin se përbërja etnike e popullsisë myslimane dhe tjetër që nuk ishte greke, në fakt ishte shqiptare në pjesën dërrmuese. Kjo për shkak se neni 2 i saj fliste vetëm për myslimanë dhe grekë. Këto dispozita, gjyqet vendore greke deri në ditët e sotme i interpretojnë duke përjashtuar identitetet etnike jogreke, duke trajtuar krejt jogrekët si myslimanë. Për të qenë ironia edhe më e madhe, këto gjyqe këtë nen kanë interpretuar sikur bëhet fjalë për minoritete fetare, jo minoritete etnike turke. Këta myslimanë jo vetëm që nuk cilësohen si turq, siç e thotë vetë titulli i **Marrëveshjes së Lozanës**, por ekskluzivisht si grekë myslimanë. Vetëm dy minoritete i njeh **Greqia** sot e kësaj dite: myslimanët dhe hebrenjtë.[47] Për minoritetin shqiptar, minoritetin çam, në rend të parë (myslimanë dhe ortodoksë), as që bëhet fjalë: ata nuk mund të jenë drejtpërdrejt e as tërthorazi subjekt i të drejtave kushtetuese. Autori i parë i këtij libri ka bërë një hulumtim të thellë në skedën e **Komisionit të Lidhjes së Kombeve** në arkivin e **Gjenevës**, gjatë viteve 1992-1993, që ka të bëjë me këmbimin e popullsive greke dhe turke sipas **Marrëveshjes së Lozanës**. Në këtë skedë gjenden dokumente dhe dëshmi origjinale të radhitura në pjesën e **Nënkomisionit për Çamëri** (konform paragrafit të dytë të nenit 11 të Marrëveshjes). Ato sot gjenden në arkivin e **Lidhjes së Kombeve në Gjenevë**, në rubrikën e Komisionit për Këmbimin e Popullsisë Greke dhe Turke sipas Marrëveshjes së Lozanës, pjesa që ka të bëjë me krahinën e **Çamërisë.**

Nga kjo shihet se garancionet kushtetuese greke të lirive dhe të drejtave të njeriut në kushtetutat në mes të dy luftërave botërore bazohen në idenë franceze **një komb-një shtet**, **një gjuhë-një komb**, duke definuar grupet etnike sipas prizmit të **ortodoksisë fetare greke** (kjo bëhet e qartë nga stipulimi i kushtetutave të viteve 1925 dhe 1911, kjo e fundit u restaurua më 1936 dhe ngeli në fuqi deri në vitin 1952). Përveç diversitetit etnik që ka qenë i ndaluar, edhe diversiteti gjuhësor nuk ka qenë i lejuar, përkatësisht nuk janë pranuar fare as minoritetet gjuhësore.[48] Kjo është e natyrshme meqë në atë kohë shqiptarët dhe minoritetet tjera kanë qenë shumë fluentë në gjuhët e tyre amtare, siç mund të vërehet nga deklaratat e tyre të dhëna Nënkomisionit nga çamët që po dëboheshin dhunshëm për Turqi (gjenden në arkivin e Lidhjes së Kombeve në Gjenevë, nën skedën **Çamëria**, kryesisht në gjuhën frënge). Kjo ka qenë pjesë e politikës së asimilimit të minoritetit shqiptar në Greqi. As Kushtetuta e vitit 1975, aktualisht në fuqi,[49] nuk ka një qëndrim tjetër sa i përket strukturës etnike të shoqërisë greke, që fare nuk reflektohet në dispozitat e saj. Përkundrazi, dispozitat e neneve 1-4 e bëjnë të qartë se populli dhe shtetësia greke janë pika referimi për identifikim, ndërkaq feja zyrtare, që mishërohet në **Kishën Autoqefale**

etnik, gjuhësor, kulturor dhe tjetër (përveç atij fetar) Andreas Calogeropoulos, "The Hellenic Republic", fq. 371-375 & 402-403.

45 **Laussanne Peace Treaty VI. Convention Concerning the Exchange of Greek and Turkish Populations Signed at Lausanne, January 30, 19123**. Article 2. Në internet: https://www.mfa.gov.tr/lausanne-peace-treaty-vi_-convention-concerning-the-exchange-of-greek-and-turkish-populations-signed-at-lausanne_.en.mfa (shikuar në mars 2022).

46 Stephanos Stavros, "The Legal Status of Minorities in Greece Today: The Adequacy of their Protection in the Light of Current Human Rights Perceptions". *Journal of Modern Greek Studies* Vol. 13, No. 1 (May 1995), fq. 1-32 në fq. 11-12.

47 Ibid., fq. 9, 17-18, 26.

48 Ibid., fq. 24.

49 **Constitution of Greece**, 1975, *as revised by the parliamentary resolution of May 27th 2008 of the VIIIth Revisionary Parliament*. (Hellenic Parliament: Athens, 2008). Të njëjtin model identifikimi e ka edhe **Republika e Turqisë**, që nga themelimi i saj deri më sot.

Ortodokse Greke,[50] shërben si definuese edhe e çdo përpjekje për definim të identitetit etnik të popullsisë, përfshirë këtu popullsinë që sot jeton në territoret e tyre etnike që njihet me emrin historik ***Çamëri*** (normal që më Kushtetutë ky emër nuk njihet dhe nuk pranohet, siç nuk njihet dhe nuk pranohet identiteti i çamëve, të krishterë e myslimanë, pronat dhe pasuria e tyre e lënë prapa pas dëbimeve tyre të dhunshëm në mes të dy luftërave botërore dhe gjatë viteve të fundit të **Luftës së Dytë Botërore** e tutje deri në mesin e viteve 1950). Në fakt, sikundër u tha, në **Greqi** nuk pranohet asnjë identitet etnik, përveç identiteti etnik mysliman dhe hebraik. Mirëpo, siç e ka konstatuar **Gjykata Permanente e Drejtësisë Ndërkombëtare** (GJPDN), në mendimin këshilldhënës të datës 31 korrik 1930 në rastin e komuniteteve **greko-bullgare**, ekzistenca e minoriteteve është çështje fakti, jo ligji.[51] Ky standard vlen edhe sot dhe është detyrë e forumeve ndërkombëtare, në rend të parë e atyre në nivel evropian, që të konstatojnë këtë fakt dhe të njohin si subjekte kushtetuese edhe minoritetin shqiptar grek, **çamët** (ortodoksë dhe myslimanë).

Sikundër u tha më sipër, **grundnorma** e parë e botës shqiptare në kuptim të parametrave të konstitucionalizmit bashkëkohor lind vetëm më datën 28 nëntor 1912, kur në Vlorë shqiptarët shprehin vullnetin e tyre politik për formën dhe përmbajtjen e ekzistencës politike, si një shtet sovran dhe i pavarur.[52] Vendimi i **Kuvendit Kushtetues të Vlorës** ka karakter të pastër konstituiv shtetëror, asnjëherë deklarativ, për shkak se me të u krijua Shteti shqiptar duke lindur grundnormën e tij të parë. Njohja e tij ndërkombëtare, ndërkaq, pra njohja e vendimit mbi formën dhe përmbajtjen e ekzistencës politike të popullit shqiptar, u bë në Londër më 29 korrik 1913, nën presionin e vazhdueshëm të **Austro-Hungarisë** dhe aleatëve të saj, **Gjermanisë** dhe **Italisë**.[53] Pjesë e saj ka qenë edhe njohja **de facto** dhe provizore e autoritetit të **Qeverisë**

---

[50] Sipas nenit 3 të Kushtetutës, që rregullon marrëdhënien e Shtetit me Kishën, **Kisha Autoqefale Greke** ka status të garantuar dhe të privilegjuar. Çdo themelim i ndonjë kishe apo institucioni tjetër fetar për predikim të cilësdo fe apo besim, duhet të ketë lejen e ministrisë përkatëse greke. Cf. për komente në Stephanos Stavros, "The Legal Status of Minorities in Greece Today: The Adequacy of their Protection in the Light of Current Human Rights Perceptions", 10-11.
Kushtetuta nuk e njeh **origjinën etnike si identitet**, por konceptin popull grek si popull sovran dhe shtetësinë si pikë referimi për identifikim si grek. Ky qëndrim është i bazuar në idenë fillestare të modeluar sipas modelit të **Revolucionit Francez**. Cf. nenet 1-4 të **Kushtetutës së Greqisë** (1975). Të njëjtin model identifikimi e ka edhe **Republika e Turqisë**, që nga themelimi i saj deri më sot.

[51] Cf. **PCIJ (Permanent Court Of International Justice), Series B. No 17 Greco-Bulgarian "Communities".** *Advisory Opinion* 31 July 1930, fq. 22-23.

[52] "[...] Të gjithë delegatët me një za venduan që Shqipëria me sot të bëhet në vehte e lirë e mosvarme". Aleks Luarasi, *AKTE JURIDIKE PËR HISTORINË E SHTETIT DHE TË DREJTËS NË SHQIPËRI*, fq. 329.

[53] Në literaturë është shënuar se **Lordi Grej** (Lord Grey: Edwatd Grey: 1862-1933), pas presionit austro-hungarez, dhe kërcënimit të se vetë do të ndërhynte për të zgjidhur çështjen e statusit juridik të Shqipërisë, ishte dorëzuar, me arsyetimin se nuk dëshironte të humbiste pushimet e verës për një çështje të tillë. Cf. më shumë për këtë në shtjellimin e shkëlqyer të Elena Kocaqi, *Si e krijoi Austro-Hungaria Shtetin shqiptar* (EMAL: Tiranë, 2019) fq. 127-150.
Forma dhe përmbajtja e vendimit mbi ekzistencën politike të **Shqipërisë londineze** konsistonte në qenien shtet sovran dhe i pavarur, "në vehte e lirë e mosvarme ". Rregullimi shtetëror (karakteri shtetit) dhe pushtetit (forma e qeverisjes) ngeli të përcaktohet me vonë. Kjo ngeli kësisoj si pasojë e faktit që ushtrimi i **pushtetit konstituiv derivativ** brenda Shqipërisë, përkatësisht konstitucionalizimi i zotimeve të grundnormës shqiptare nuk mund të realizohej për shkak të kaosit të krijuar nga prezenca e ushtrive të huaja në territorin shqiptar në veri dhe jug (në pjesën më të madhe të territorit të sotëm shqiptar, ndoshta me përjashtim të Shqipërisë së mesme efektivisht). Një gjendje e tillë domosdo impononte nevojën e ndihmën dhe bashkëpunimit me faktorin ndërkombëtar që ishte dashamirës i çështjes shqiptare dhe që kishte mirëkuptim për këtë çështje, në përpjekjet e tyre për të ndaluar dhe zmbrapsur ndikimin ekspansionist rus në Ballkan. Këto konfiguracione gjeostrategjike bënë që vënia në jetë e Deklaratës së Pavarësisë të bëhet në bashkëpunim të ngushtë, pse jo edhe nën urdhrat e sponsorëve të krijimit të Shtetit të ri shqiptar, të cilët kishin të njëjtit armiq me shqiptarët. Përkundër qasjes krejtësisht komuniste në interpretimin e historisë së ngjarjeve që çuan në krijimin e **Shtetit shqiptar** dhe konsolidimin e tij në vitet pas shpalljes së pavarësisë, historiani shqiptar **Muin Çami** (1923-2011), me të drejtë ka konstatuar se qëndrimi i ndryshëm i dy fuqive të **Adriatikut** (Italisë dhe Austro-Hungarisë), nga ai i monarkive ballkanike (**Bullgarisë**, **Greqisë**, **Serbisë** dhe **Malit të Zi**), kishte përcaktuar edhe qëndrimin e tyre ndaj **Lëvizjes Kombëtare** të popullit shqiptar dhe anasjelltas. Cf. Muin Çami, *Shqipëria në marrëdhëniet ndërkombëtare (1914-1918)* (Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë-Instituti i Historisë: Tiranë, 1987) fq. 32 (autori nga fq. 32-41 shtjellon këtë tezë, bazuar në fakte historike, mirëpo interpretimi i tij është skajshmërisht komunist dhe bazohet në qasjen dogmatike të Leninit mbi borgjezinë si forcë pashmangësisht destruktive dhe regresive e secilës shoqëri në botë).Akti i parë juridik që shpreh ushtrimin efektiv të **pushtetit konstituiv** të **Shqipërisë**, që njëkohësisht ka karakterin e instrumentit të parë e themelor ndërkombëtar që njeh pavarësinë e Shqipërisë, por që në asnjë mënyrë nuk mohon vendimin e 28 nëntorit 1912, është miratuar pak më vonë, siç ndodh zakonisht me krijimin e shteteve të reja që presin njohjen ndërkombëtare të **grundnormës** së tyre. Ky akt i parë juridik-ndërkombëtar, ka përcaktuar formën dhe përmbajtjen kushtetuese si dhe statusin ndërkombëtar të vendimit mbi ekzistencën politike që krijoi Shqipërinë londineze. E kemi fjalën për vendimin e **Londrës** të datës 29 korrik 1913, me të cilin u saktësua karakteri i shtetit dhe forma e pushtetit që instalohet në Shqipëri me ndihmën e **Fuqive**

së Vlorës, deri në vendosjen e autoriteteve ndërkombëtare të krijuara me vendimin e sipërcekur të 29 korrikut.[54] Kjo njohje e përkohshme nuk u bë për shkak se **Kuvendi Kushtetues i Vlorës** nuk pati ndonjë legjitimitet të dal nga vota, sepse të tillë legjitimitet nuk gëzonin as kuvendet dhe organet kushtetuese të vendeve përreth trojeve shqiptare të kohës, përfshirë dhe kuvendet e tyre kushtetuese që kishin miratuar deklaratat e pavarësisë në shekullin pararendës (Bullgaria, Greqia, Mali i Zi dhe Serbia). [55]Arsyeja për një njohje të përkohshme të autoriteteve të **Vlorës** u bë për shkak të rivaliteteve ndërkombëtare si dhe nga frika që njohja e tyre mund të shkaktonte më shumë koas të brendshëm dhe do të provokonte ndërhyrjen e mëtutjeshme të vendeve fqinje, që edhe ashtu ishin mjaft aktive kundër integritetit territorial të Shqipërisë londineze.

Nga shtjellimi si më sipër shihet që, në fillim, implementimi i **grundnormës** së 28 nëntorit 1912 nuk ishte shoqëruar me nxjerrjen e akteve të tjera juridike që kanë karakterin e kushtetutës formale: u nxorën ligje e akte të tjera juridike për rregullimin e procedurave penale, shërbimit civil, forcave të rendit dhe ruajtjes së qetësisë publike dhe kështu me radhë. Këto u quajtën me një emër: "statutet e Vorës", sipas idesë dhe kërkesave të qeverisë së Vlorës për të vënë në jetë sa më herët idenë e **grundnormës** së sponsorizuar nga ajo më 28 nëntor 1912. Jo vetëm kaq! As vetë natyra juridike e këtyre statuteve nuk kishte cilësinë e normave kushtetuese, në kuptim të kushtetutës formale.[56] Akti i parë që pati këtë natyrë ka qenë **Statuti i Përkohshëm i Këshillit Ndërkombëtar të Kontrollit** (**KNK**), i proklamuar më 10 prill 1914.[57] Ky dokument, që përfaqëson kushtetutën e parë formale të Shtetit shqiptar, përcaktoi formën dhe përmbajtjen e shtetit dhe pushtetit që ishte shpallur, duke mos vënë asnjëherë në dyshim vendimin konkret të shqiptarëve për formën dhe përmbajtjen ekzistencës së tyre politike. Baza juridike imediate e Statutit, megjithatë, nuk ka qenë **grundnorma** e vjeshtës 1912, por vendimi i Londrës i 29 korrikut 1913, me të cilin njihej ekzistenca e pavarur dhe në vete e popullit shqiptar, sipas përcaktimeve të **Kuvendit të Vlorës**, pa asnjë lidhje vasaliteti me **Perandorinë Osmane**. Për nga natyra, ai ishte një akt kushtetues liberal, por jo demokratik sepse nuk buronte nga vullneti i kushtetutëbërësit shqiptar, por nga një vendim ndërkombëtar. Me të përcaktohej monarkia kushtetuese si formë e qeverisjes, sipas modelit të kushtetutave franceze të kohës së restaurimit, pra ishte një kushtetutë e dhuruar, në të cilën princi kishte pushtet të madh, kurse përfaqësimi parlamentar ishte mjaft i kufizuar.[58] Në këtë kuptim, ky akt kushtetues hyn në grupin e prodhimeve të dala nga ushtrimi i pushtetit konstituiv derivativ nga ana e faktorit të jashtëm (pushteti kushtetutëbërës i internacionalizuar). Imponimi i zgjidhjeve kushtetuese do të haset më vonë në mes të dy luftërave botërore dhe pas vitit 1945.

---

të Mëdha (Austro-Hungaria, Britania e Madhe, Gjermania, Franca, Italia dhe Rusia), të cilat thuajse në tërësi ndikoheshin nga Austro-Hungaria (kryesisht e mbështetur nga Gjermania dhe Italia): tani e tutje vendi bëhet principatë autonome, sovrane dhe e trashëguar sipas rendit të paralindur, ndërkombëtarisht shtet neutral me garancione ndërkombëtare, pa asnjë lidhje juridike sovraniteti me Turqinë. Cf. Elena Kocaqi, *Si e krijoi Austro-Hungaria Shtetin shqiptar*, fq. 146-150; Për rrjedhën e ngjarjeve para dhe pas shpalljes së pavarësisë, sipas procesverbaleve, telegrameve dhe dokumenteve të ruajtura të kohës, cf. më shumë në Lef Nosi, *DOKUMENTE HISTORIKE* (1912-1918) (Instituti i Historisë: Tiranë 2007), fq. 69-185; Për komentet shtesë, cf. Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926* (Botimet DUDAJL 2010), fq. 107-108).

54 "[…] Neni 7. Princi do të caktohet jo më vonë se brenda gjashtë muajsh. Në pritje të caktimit të princit dhe formimit të qeverisë kombëtare definitive, funksionimi i autoriteteve vendase ekzistuese si dhe i xhandarmërisë, do të jetë nën kontrollin e Komisionit Ndërkombëtar". Cituar sipas Aleks Luarasi, *AKTE JURIDIKE PËR HISTORINË E SHTETIT DHE TË DREJTËS NË SHQIPËRI*, fq. 352. Sikundër shihet, këtu bëhet fjalë për pranimin si fakt të ekzistencës së autoriteteve vendore që krijoj **Qeveria e Ismail Qemajlit** dhe faktin tjetër që ato ishin të përkohshme, sepse vendimi përdor fjalinë "në pritje të caktimit të princit dhe formimit të qeverisë kombëtare definitive". Me këtë nuk lejohet vakum juridik në mes të pushtetit të lindur nga **grundnorma** dhe atij që u krijua në bazë të tij, duke bërë të qartë këtu se bëhet fjalë për ushtrimin e pushtetit konstituiv derivativ brenda kuadrit juridik që nuk i përket ish-**Perandorisë Osmane**, por atij të prodhuar nga shqiptarët në Vlorë. Për këtë arsye edhe me vend përdoret shprehja "autoritete vendore".

55 Ndikimi i faktorit ndërkombëtar në krijimin e këtyre shteteve në shekullin XIX ka qenë vendimtar, pa mohuar në asnjë rast luftën për pavarësi e sovranitet që këto shtete e kishin bërë kundër Perandorisë Otomane. Mbizotërimi i parimit ndërkombëtar, nuk përjashton domosdo realizimin e parimit nacional. Cf. Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926,* fq. 120-121 (ani se ky autor, në këtë libër, fuqishëm beson në të kundërtën e kësaj, përkatësisht në atë se ngjarjet që çuan në krijimin e Shtetit shqiptar më 28 nëntor 1912 kanë qenë ekskluzivisht rezultat i përpjekjeve shqiptare, kurse roli e pozita e Fuqive të Mëdha ka qenë një koincidencë e rastit që është diktuar nga interesat e tyre meskine imperialiste për zaptim të territoreve shqiptare).

56 Aurela Anastasi, *HISTORIA E TË DREJTËS KUSHTETUESE NË SHQIPËRI (1912-1939)*, fq. 31.

57 Për tekstin e plotë të Statutit të **KNK**, cf. Aleks Luarasi, *AKTE JURIDIKE PËR HISTORINË E SHTETIT DHE TË DREJTËS NË SHQIPËRI*, fq. 353-383.

58 Aurela Anastasi, *HISTORIA E TË DREJTËS KUSHTETUESE NË SHQIPËRI (1912-1939)*, fq. 34-35.

Ushtrimi autentik i pushtetit konstituiv derivativ në **Shqipërinë londineze**, për herë të parë ndodhi me mbajtjen e **Kongresit të Lushnjës** (1920), në kohë e rrethana shumë më të ndryshme se ato që kishin ekzistuar para Luftës së Parë Botërore. Kongresi, që zhvilloi punimet nga 28 deri 31 janar 1920, kurse më 31 janar 1920 u miratua **Statuti i Lushnjës**, që bëri kushtetimin e shtetit shqiptar, si një shtet plotësisht sovran dhe i udhëhequr nga institucionet e krijuara nga vetë shqiptarët. Ky kuvend shqiptar pati jehonë dhe rëndësi në kohën kur **Qeveria e Durrësit** (dhjetor 1918-janar 1920) nuk arriti të imponohej në **Versajë**, ku po mbahej konferenca ndërkombëtare dhe vendosej fati i popujve, përfshirë fati i Shqipërisë. Përkundër përpjekjeve titanike serbe e greke për mohim të ekzistencës së saj, në Versajë mbizotëroi parimi i nacionalitetit, i proklamuar nga Presidenti i SHBA-së **Udro Uilson** (Thomas Woodrow Wilson: 1856-1924). Një faktor tjetër i favorshëm për Shqipërinë dhe konsolidimin e shtetësisë së saj ka qenë fakti që faktori rus kishte humbur ndikimin, si pasojë e **Revolucionit të Tetorit** (1917) dhe daljes së Rusisë nga lufta.[59] Britania, si fuqia kryesore e **Evropës**, kishte mirëkuptim për realizimin e vendimeve të para **Luftës së Parë Botërore**, duke zëvendësuar në masë të madhe rolin që kishte pasur Austro-Hungaria, kurse Italia, pas disfatës në **Luftën e Vlorës** (1920) dhe zbulimit të **Traktatit të Londrës** (1915), me të cilin synohej copëtimi Shqipërisë, u dorëzua para kërkesave shqiptare për pavarësi e sovranitet të plotë.

Pas **Lushnjës**, e cila, sikundër u tha, miratoi aktin e parë që realizon në mënyrë autentike ushtrimin e pushtetit konstituiv derivativ lidhur me karakterin e shtetit dhe formën e qeverisjes në Shqipërinë londineze,[60] vjen ushtrimi i radhës i pushtetit konstituiv derivativ që çoi në krijimin e **Republikës së Shqipërisë**,[61] i pasuar nga një ushtrim tjetër i këtij pushteti ndryshoi sërish në mënyrë rrënjësore karakterin e Shtetit dhe formën e qeverisjes së Shtetit shqiptar, duke e rikthyer monarkinë dhe qeverisjen monarkike në personin e **Mbretit Zogu i Parë** (Zogu I, Mbreti i Shqiptarëve: 1895-1961). Kjo monarki mori fund me pushtimin italian dhe dorëzimin e kurorës shqiptare Shtëpisë së Savojës, përkatësisht **Mbretit Perandor Emanueli III** (Victor Emmanuel III: 1869-1947) nga një asamble kushtetuese që u mbajt më 12 prill 1939.[62] Ky dorëzim i kurorës dhe asambleja kushtetuese që kishte marrë vendim për një gjë të tillë, së bashku me një asamble tjetër të ngjashme nga koha e okupimit gjerman të Shqipërisë, që u mbajt më 14 shtator 1943 për të riformuar **Mbretërinë Shqiptare**,[63] u shpallën absolutivsht të pavlefshëm nga aspekti i të drejtës ndërkombëtare. Kjo u bë konform dispozitave të **Kartës së Atlantikut** (gusht 1941), që më pas u përligjësuan me **Kartën e OKB**-së (qershor 1945) që i ndalon ndryshimet territoriale përmes përdorimit të dhunës. Në këtë mënyrë u shpallën si të jashtëligjshme ndryshimet territoriale që ishin kryer

59 Cf. Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926,* fq. 295-311.

60 Zgjerimi që iu bë **Statutit të Lushnjës**, i cili në histori njihet si statuti i shtetit shqiptar i vitit 1922, e shndërroi këtë akt në një kushtetutë të mirëfilltë me fuqinë më të lartë në shtet dhe sanksionoi plotfuqinë parlamentare.

61 Dy faktorë kanë qenë vendimtarë që kanë çuar në krijimin në janar të vitit 1925 të republikës së parë shqiptare: i pari ka qenë nevoja për një dorë të fortë, për t'i dhënë fund anarkisë së krijuar në vend dhe për të konsoliduar legjitimitetin ndërkombëtar të Shtetit shqiptar; dhe, e dyta, frika e **Ahmet Zogut** se, në rast të vendosjes për vënien në krye të Shtetit shqiptar një monark, në vend të **Këllit të Naltë** (Regjenca) që ishte themeluar me **Statutin e Lushnjës** të datës 31 janar 1920, do të hapte dyert e rikthimit të **Princit Vid** (Prince Wilhelm of Wied: 1876-1945). Krahas ndryshimit të karakterit të shtetit, nga një monarki kushtetuese, që kishte ekzistuar formalisht edhe pas largimit të **Vidit** dhe vënies së Regjencës me **Statutin e Lushnjës**, në një republikë parlamentare, Asambleja Kushtetuese pushoi së vepruari në këtë cilësi dhe u kthye në një organ ligjvënës që miratoi **Statutin Themeltar të Republikës Shqiptare** (u botua në "Fletoren Zyrtare" më 7 mars 1925). Kjo do të thotë se organi që miratoi kushtetutën e Republikës së parë shqiptare nuk ishte asamble kushtetuese, por parlament (ligjvënës) i zakonshëm. Cf. më shumë për këtë në Afrim Krasniqi, *Sistemet politike në Shqipëri*. Botimi dytë (UFO Press: Tiranë, 2009) fq. 112-114; Mal Berisha, HERMAN BERNSTEIN. Ambasador i SHBA-ve në Mbretërinë Shqiptare (EduAlba: Tiranë, 2017), fq.125-135; Fatmira Musaj, *Republika Shqiptare: 1925-1928* (Instituti i Historisë: Tiranë, 2018), fq. 57-71; Afrim Krasniqi, *Sistemet politike në Shqipërisë*. Botimi dytë (UFO Press: Tiranë, 2009) fq. 112-114.

62 Cf. më shumë në Romeo Gurakuqi, *Shqipëria dhe "Tokat e Lirueme": 1939-1946* (Botimet Josef: Tiranë, 2018), fq. 75-85 (kjo ka çuar në bashkimin personal të **Shqipërisë** me **Italinë**, dmth mbreti Emanuli III ishte njëkohësisht mbret i **Shqipërisë** dhe perandor i **Etiopisë**).

63 Në fakt, këtë vendim e ka marr një grupim i njerëzve, Komisioni Nismëtar Shqiptarësh, që gradualisht do të themelonin një **Komitet Nacional Ekzekutiv**, me në krye **Mehdi Frashërin** (1862-1963). Vendimi konsistonte në anulimin e vendimit mbi dorëzimin e kurorës Mbretit Perandor **Viktor Emanulei III** dhe rikthimin e gjendjes siç kishte qenë para datës 7 prill 1039. Ky grup i njerëzve formoi qeverinë nacionale dhe një kuvend kushtetues. Ky i fundit ndërmori formimin e Regjencës, duke ruajtur kësisoj formën monarkike të Shtetit Shqiptar, nën okupimin gjerman. Si dokument kushtetues mbi të cilin u mbështet puna e këtyre organeve ishte **Statuti i Mbretërisë Shqiptare** i datës 1 dhjetor 1928. Me këta hapa, **Komiteti Nacional** synonte ruajtjen e legalitetit të Shtetit shqiptar, por në kufij të zgjeruar (me **Kosovën** dhe trojet tjera shqiptare nën ish-**Jugosllavi** si pjesë e këtij shteti të ri). Cf. më shumë në Romeo Gurakuqi, *Shqipëria dhe "Tokat e Lirueme": 1939-1946*, fq. 592-606.

si pasojë e okupimeve ushtarake nga **Fuqitë e Boshtit** (Gjermania, Italia dhe Japonia me aleatët e tyre) përgjatë Luftës së Dytë Botërore (1 shtator 1939-9 maj 1945).

Kjo si më sipër nënkupton se Shteti shqiptar kishte ruajtur ekzistencën e vet si shtet sovran dhe i pavarur, gjithnjë nga aspekti i të drejtës ndërkombëtare, siç kishin ruajtur edhe ish-Jugosllavia dhe të gjitha vendet e Ballkanit e Evropës që u shkatërruan si formacione politike nga pushimet e **Fuqive të Boshtit**. Pas restaurimit të shtetësisë juridiko-ndërkombëtare të këtyre vendeve, në mbarim të **Luftës së Dytë Botërore**, **Shqipëria** ra nën **ndikimin sovjetik**, së bashku me vendet tjera të **Ballkanit** (me përjashtim të **Greqisë** dhe **Turqisë**), sipas vendimeve të Konferencës së Jaltës mbi ndarjen e **sferave të interesit** (shkurt 1945). Rregullimi brendshëm kushtetues ngeli në duart e popullit shqiptar, siç kishte ndodhur edhe me popujt tjetër të lindjes ish-komuniste. Në vijim të ushtrimit të pushtetit të ri konstituiv, me qëllim të rregullimit të brendshëm kushtetues, ka ardhur deri te nxjerrja e kushtetutave komuniste të viteve 1946 dhe 1976,[64] të cilat nuk kishin asnjë dallim thelbësor nga kushtetutat sovjetike të kohës, sipas të cilave modeloheshin. Në fund, me prishjen e komunizmit dhe mbarimin e **Luftës së Ftohtë** (1947-1991), vjen deri te hapja e mundësive për miratimin e dokumentit të parë kushtetues, të lirë dhe të brumosur me standardet themelore të konstitucionalizmit liberal perëndimor. Kjo u bë me miratimin e **Ligjit Nr. 7491, datë 29.4.1991 për dispozitat kryesore kushtetuese**, kurse në vitin 1998, më në fund, edhe deri te nxjerrja e kushtetutës së plotë, e cila sot është në fuqi. Kjo kushtetutë sanksionon një sistem të mirëfilltë kushtetues që bazohet në vlerat e konstitucionalizmit demokratik liberal-perëndimor, me fokus në individin dhe lirinë e tij.

Nga vendet tjera përreth Kosovës që kanë pasur kushtetutat e tyre, **Maqedonia e Veriut, Mali i Zi** dhe **Serbia** hyjnë në radhë për diskutim vetëm sa i përket historisë së tyre kushtetuese pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe fitimit të pavarësisë së tyre. Në periudhën 1946-1991, këto republika kanë qenë njësi federale e ish-Jugosllavisë komuniste, e cila para **Luftës së Dytë Botërore** ka pasur karakter të monarkisë kushtetuese, e shpallur më 1 dhjetor 1918 nën emrin Mbretëria Serbo Kroato-Sllovene (e riemërtuar në "Mbretëria Jugosllave" pas vitit 1939). Për rrjedhojë, zhvillimi i konstitucionalizmit në këto republika është i njëjtë dhe i përbashkët, në ndërkohë që për pozitën kushtetuese të shqiptarëve në këto republika mund të bëhet fjalë vetëm pas pavarësimit të tyre, përkatësisht pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë në pranverë të vitit 1992. Në kohën e ish-Jugosllavisë, pozita e shqiptarëve është përcaktuar nga kushtetutat federale, kurse në kohën ndërmjet dy luftërave botërore as që mund të flitet për ndonjë pozitë apo identitet kushtetues dhe tjetër të njohur për shqiptarët, siç do të sqarojmë në vijim. Në këtë kontekst, për **historinë kushtetuese të shqiptarëve nën ish-Jugosllavi** (1918-1992), me rëndësi janë dokumentet kushtetuese për sa vijon (të cilat janë të përbashkëta edhe për vendet fqinje të Kosovës, me përjashtim të Shqipërisë):

- Akti i datës 1 dhjetor 1918;[65]
- **Kushtetuta e Vidovdanit** e datës 28 qershor 1918;[66]
- Ligji mbi pushtetin mbretëror dhe administratën supreme shtetërore i datës 6 janar 1929;[67]
- Kushtetuta e dhuruar e datës 3 shtator 1931;[68]

[64] Kushtetuta e parë komuniste është nxjerrur më 11 janar 1946, e amendamentuar në vitin 1950. Pas kësaj ka pasuar Kushtetuta e vitit 1976, e cila ka ngelur në fuqi deri në vitin 1991, kur u nxorr Ligji nr. 7491 i datës 29 prill 1991. Për historinë kushtetuese të Shqipërisë komuniste, menjëherë pas nxjerrjes së Kushtetutës së vitit 1946 e deri në fillim të viteve '70 të shekullit të kaluar, cf. më shumë në Dhimo M. Dhima, *E DREJTA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË.*

[65] Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr latin/home/glavnanavigacija/leksikon jugoslavije/konstituivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 mars 2022).

[66] Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr latin/home/ glavnanaviga c ija/leksikon jugoslavije/ konstituivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 mars 2022).

[67] Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavnanavigacija/leksikon_ jugoslavije/ konstituivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 mars 2022).

[68] Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna_ navigacija/leksikon_ jugoslavije/konstituivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 mars 2022).

- Rezoluta mbi themelimin e **KAÇKJ** e datës 27 nëntor 1942;[69]
- Deklarata e Mbledhjes së Dytë të **KACKJ** e datës 29 nëntor 1943;[70]
- Marrëveshja e Beogradit **Tito Shubashic** e datës 1 nëntor 1944;[71]
- Rezoluta e shpalljes së **KACKJ** si Kuvend i Përkohshëm Populllor Republikës Demokratike të Jugosllavisë;[72]
- Deklarata mbi shpalljen e **RFPJ** e datës 29 nëntor 1945;[73]
- **Kushtetuta e RFPJ** e datës 31 janar 1946;[74]
- Ligji kushtetues mbi bazat e rregullimit shtetëror dhe politik të Republikës Federative Populllore të Jugosllavisë dhe organet federative të pushtetit i datës 13 janar 1953;[75]
- **Kushtetuta e RSFJ** e datës 7 prill 1963;[76]
- Amendamentet në Kushtetutën e RSFJ të vitit 1963;[77]
- **Kushtetuta e RSFJ** e datës 21 shkurt 1974;[78]
- Amendamentet në **Kushtetutën e RSFJ** të vitit 1974;[79]
- **Kushtetuta e KSAK** e datës 28 shkurt 1974;[80]
- Amendamentet në Kushtetutën e KSAK;[81]
- **Kushtetuta e Kaçanikut** e datës 2 shtator 1990;[82]
- **Kushtetuta e RFJ** e datës 27 prill 1992;[83]
- **Marrëveshja e Rambujesë** e shkurt-marsit 1999;[84]
- **Rezoluta 1244** e OKB-së për Kosovën e datës 10 qershor 1999 dhe dokumentet tjera të nxjerra në bazë të saj, përfshirë këtu **Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,** datë 15 maj 2001;[85]

---

69 Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna_ navigacija/leksikon_ jugoslavije/konstituivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 mars 2022).

70 Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna_ navigacija/leksikon_ jugoslavije/konstituivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 mars 2022).

71 Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna_ navigacija/leksikon_ jugoslavije/konstituivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 mars 2022).

72 Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna_ navigacija/leksikon jugoslavije/konstituivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 mars 2022).

73 Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna_ navigacija/leksikon_ jugoslavije/konstituivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 mars 2022).

74 Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna_ navigacija/leksikon jugoslavije/konstituivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 mars 2022).

75 Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna_ navigacija/ leksikon-jugoslavije/konstituivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 mars 2022).

76 Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna_ navigacija/ leksikon-jugoslavije/konstituivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 mars 2022).

77 Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna_ navigacija/ leksikon-jugoslavije/konstituivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 mars 2022).

78 Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna_navigacija /leksikon-jugoslavije/konstituivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 mars 2022).

79 Për tekstin e plotë të amendamenteve, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna navigacija/leksikonjugoslavije/konstituivni_akti_jugoslavije.html (shikuar më 30 nëntor 2017); Për analizën e nisjes së krizës jugosllave dhe shkaqet e saj, cf. më shumë në Mari-Žanin Čalić, *ISTORIJA JUGOSLAVIJE U XX VEKU*, (CLIO: Beograd, 2013), fq. 327-379.

80 **Kushtetuta e KSA të Kosovës**. *Gazeta Zyrtare e KSAK* nr. 4. Prishtinë, 27 shkurt 1974.

81 **Amendamentet XVIII-LV në Kushtetutën e KSAK**. *Gazeta Zyrtare e KSAK* nr. 24. Prishtinë, 10 korrik 1989.

82 **Kushtetuta e Kacanikut, 7 shtator 1990**.

83 Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavnanavigacija/ leksik onjug oslavije/konstituivni_akti_jugoslavije.html (shikuar në mars 2022).

84 **Rambouillet Accords: Interim Agreement for Peace and Self-Government in Kosovo**. *Letter dated 4 June 1999 from the Permanent Representative of France to the United Nations Adressed to the Secretary General.* Security Council S/1999/648. 7June 1999. English. Original: French (shikuar në mars 2022).

85 **Resolution 1244 (1999)**. *Adopted by the Security Council at its 4011th meeting, on 10 June 1999*. Security Council. S/RES/1244 (1999) 10 June 1999. Original: English. Në internet: https://documents-dds-ny.un.org/doc/ UN DOC /GEN/N99/172/89/PDF/N9917289.pdf?OpenElement (shikuar në mars 2022); **Kornizë Kushtetuese**

- **Marrëveshja e Beogradit** dhe **Karta Kushtetuese** e USMZ;[86]
- **Kushtetuta e Serbisë** e datës 30 shtator 2006;[87]
- **Plani Ahtisari** i datës 2 shkurt 2007; [88]
- **Deklarata e Pavarësisë e datës 17 shkurt 2008**;[89]
- **Kushtetuta** e vitit 2008 (me amendamentet e mëpastajme).[90]

Në aspektin kushtetues, sikundër shihet, këtu hyjnë edhe dokumentet pas vitit 1992, deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës, kur në vend vjen deri te ndërprerja e kontinuitetit juridik- kushtetues dhe juridik-ndërkombëtar me rendin juridik-kushtetues pararendës, që ishte instaluar nga **UNMIK** (autoriteti ndërkombëtar i OKB-së në Kosovë pas qershorit 1999). Thënë ndryshe, diskutimi në vijim përfshinë dokumentet kushtetuese, apo me rëndësi kushtetuese, që janë nxjerrë para dhe pas pavarësimit të Kosovës, duke kapur kësisoj **një periudhë gati njëshekullore** me rëndësi për **historinë kushtetuese të Kosovës** dhe **shqiptarëve në ish-Jugosllavi.**

Gjatë Mbretërisë **SKS/Jugosllavisë** (1918-1943), Kosova nuk ka pasur identitet të veçantë kushtetues e as identitet tjetër politik apo territorial. Ajo nuk ka qenë e njohur si territor i veçantë, kurse popullsia e saj nuk ka gëzuar asnjë njohje kushtetuese. Në këtë drejtim, Kosova nuk ka qenë e vetme: boshnjakët, malazezët dhe maqedonasit gjithashtu nuk kanë gëzuar asnjë njohje kushtetuese (në aspektin nacional apo territorial). Kjo gjendje ka qenë pasojë e mënyrës së formimit të ish-Jugosllavisë më 1 dhjetor 1918, si dhe e rrethanave historike që i kanë paraprirë këtij formimi. Këto dy aspekte më pas janë reflektuar në të gjitha dokumentet kushtetuese jugosllave deri në shkatërrimin e parë të atij shteti më 6 prill 1941 nga sulmi ushtarak i **Gjermanisë së Hitlerit** (Adolf Hitler: 1889-1945)**.**

Sikundër u pa më sipër, dhe siç do të argumentohet në vijim, **akti themelues i datës 1 dhjetor 1918** paraqet dokumentin e parë me rëndësi kushtetuese në procesin e krijimit të ish-Jugosllavisë. Me këtë akt, mbreti serb i dinastisë **Karagjorgjeviq** proklamoi bashkimin e **Mbretërisë së Serbisë** me vendet e banuara me sllovenë, kroatë dhe serbë që i kishin takuar **Austro-Hungarisë**. Si i tillë, ai shërbeu si **bazë juridike** për themelimin e pushtetit të ri, krahas karakterit konstituiv (themeloi shtetin e ri, ish-Jugosllavinë) dhe ngeli në jetë derisa u nxor **Kushtetuta e Vidovdanit** më 28 qershor 1921. Në këtë periudhë, pushtetin e kanë përfaqësuar mbreti, përkatësisht regjenti **Aleksandër Karagjorgjeviq**, qeveria dhe **Kuvendi i Përkohshëm Përfaqësues Popullor** (**Kuvendi i Përkohshëm**). Më datën 20 dhjetor 1918, u bë formimi i qeverisë së parë, kurse Kuvendi i Përkohshëm u takua më datën 1 mars të vitit në vijim. Pushteti shtetëror ishte absolut dhe i centralizuar në duar të mbretit serb. Kjo rrethanë vinte si pasojë e raportit të forcave në favor të serbëve, të cilët kishin detyruar popujt tjerë joserbë për unifikim me **Mbretërinë Serbe** para se të themelohej shteti i ri jugosllav: në nëntor të vitit 1918 u aneksua **Mbretëria e Malit të Zi** që kishte ekzistuar nga viti 1910 deri në 1918, kur u aneksua së bashku me **Vojvodinën** dhe vendet tjera që gjendeshin nën okupim ushtarak serb.

Si detyrë e parë e shtetit të ri, që dilte nga premtimi i dhënë me aktin e datës 1 dhjetor 1918, nga regjenti **Aleksandar Karagjorgjeviq** në emër të mbretit serb **Petri i Parë**, ka qenë themelimi i qeverisë, e cila

për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (15 maj 2001). Në internet: https://www.kuvendiKosovës.org/ common/ docs/ FrameworkPocket_ALB_Dec2002.pdf (shikuar në mars 2022).

86 **Sporazum o principima odnosa Srbije i Crne Gore u okviru drzavne zajednice** (14 mars 2002). Në internet: http://www.montenet.org/2002/osnove.html (shikuar në janar 2018); **Ustavna povelja drzavne zajednice Srbija i Crna Gora** (4 februar 2003) *Službeni list Srbije i Crne Gore*, br. 1/2003. Në internet: http://mojustav.rs/ wp-content/uploads/2013/04/ustavna_ povelja_ scg. pdf (shikuar në mars 2022).

87 **Ustav Republike Srbije.** Në internet: http://www.ius.bg.ac.rs/prof/materijali/martan /UstavSrbije.pdf (shikuar në mars 2022).

88 **Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës 2 shkurt 2007.** Në internet: https:/ / www.kuvendiKosovës.org/common/docs/Propozim%20për%20Statusin%20e%20Kosovës.pdf (shikuar në mars 2022).

89 Cf. seksioni 5.2, **infra**, në këtë pjesë, dhe komentet tona rreth **Deklaratës së Pavarësisë**.

90 Cf. seksioni 5.2, **infra**, në këtë pjesë, dhe komentet tona rreth **Kushtetutës së Kosovës**.

do t'i përgjigjej kuvendit, si dhe caktimi i kufijve mbi bazën e parimit etnografik. Kjo e fundit nuk ka ndodhur asnjëherë gjatë tërë kohës së ekzistimit të atij shteti. Kjo nuk ka ndodhur sepse asnjëherë seriozisht nuk është menduar caktimi i kufijve mbi baza të tilla, me përjashtim të **Banovinës Kroate**, e cila u krijua në vitet e fundit të jetës së atij shteti.[91] Kjo gjendje e sundimit autoritar të dinastisë Karagjorgjeviq u reflektua edhe në kushtetutën e parë, e njohur si **Kushtetuta e Vidovdanit** (festë kishtare serbe).

Kushtetuta e Vidovdanit u miratua nga një kuvend kushtetues më datën 28 qershor 1921. Miratimi u bë me një shumicë të thjeshtë të votave dhe me një refuzim të tërësishëm të saj nga sllovenët dhe kroatët. Refuzimi synonte të bllokonte tendencat hegjemoniste serbe dhe ishte pasojë e drejtpërdrejtë e dallimeve thelbësore në mes të serbëve, në njërën anë, dhe sllovenëve e kroatëve, në anën tjetër, sa i përket rregullimit shtetëror dhe formës së qeverisjes: derisa sllovenët e kroatët insistonin për një rregullim shtetëror republikan me bazë federative, serbët fuqishëm dhe me dhunë insistonin për një rregullimin monarkik unitar dhe me pushtet të centralizuar. Në aspektin formal, Kushtetuta bënte fjalë për barazi në mes të tre popujve në ndarjen e pushtetit të ri. Në praktikë, megjithatë, mbreti merrte pjesë në ushtrimin e tri formave të pushtetit. Rregullimi kushtetues centralist, ndërkaq, buronte nga botëkuptimi serb i kohës mbi unitetin shtetëror i cili shprehej përmes formulës së njohur që thoshte se **Mbretëria SKS** paraqet një mbretëri të një populli me tre emra. Këta tre emra ishin: kroatët, serbët dhe sllovenët.[92] Kjo qasje përbënte një politikë zyrtare që shtypte çdo diveristet nacional, gjuhësor dhe tjetër në favor të theksimit të tezës se **Mbretëria SKS** ishte një dhe e vetme, e **një populli me tre emra**.[93] Si e tillë nuk ndryshoi aspak me abrogimin e **Kushtetutës së Vidovdanit** dhe futjen e diktaturës së njohur (më 6 janar 1929). Pushteti unik, i pandarë dhe tërësisht i centralizuar i dinastisë serbe **Karagjorgjeviq**, si dhe ideologjia e **jugosllavizmit** integral nuk pranonin asnjë diversitet nacional, etnik, gjuhësor dhe tjetër. Me rastin e futjes së kësaj diktature, në mënyrë shumë brutale dhe të hapur, mbreti serb **A. Karagjorgjviq** shpërndau parlamentin dhe imponoi regjimin personal.[94]

---

91 "Uredba o podeli zemlje na oblasti ". *Sluzbene Novine Kraljevine SHS* Br. 92 (26 april 1922). Për komentet, cf. Ana S. Trbovich, *A Legal Geography of Yugoslavia's Disintegration* (Oxford University Press: Oxford, 2008) (kapitulli i 3-të flitet gjerësisht për kufijtë administrativ të ish-Jugosllavisë (1918-1992) dhe për mosrespektimin e kritereve etnike dhe historike me rastin e caktimit të tyre, me përjashtim të rastit të **Banovinës Kroate** që u themelua në prag të Luftës së Dytë Botërore). Po ashtu, cf. edhe **Omer Hamzić**, "Ustavno određenje i realni odnosi između organa uprave i samouprave u prvoj deceniji Kraljevine SHS". *Gracanicki glasnik* Broj 31 (maj 2011) fq. 36-49.

92 Për një trajtim të shkëlqyer të pikëpamjeve serbe, në njerën anë, dhe të atyre kroato-sllovene, në anën tjetër, të cilat u sanksionuan me **Kushtetutën e Vidovdanit** në favor të serbëve dhe botëkuptimit të tyre mbi unitetin shtetëror, si kundërpozicion ndaj konceptit federalist të kroatëve e sllovenëve, shih më shumë në librin e konstituciuonalistit të mirënjohur serb Slobodan Jovanovic, *Ustavno pravo Kraljevine srba, hrvata i slovenaca* (Sluzbeni list SRJ: Beograd, 1995) (në alfabetin cirilik vetëm) fq. 31-98 (në kapitullin hyrës autori jep historinë e procesit të formimit të **Jugosllavisë** gjatë dhe pas **Luftës së Parë Botërore**, dallimet në mes të projekteve kushtetuese kroate e sllovene me ato centraliste serbe; në dy kapitujt e parë të pjesës së parë, autori flet në mënyrë të detajuar rreth konceptit të mbretërisë që thuhej se qe e përbërë nga një popull me tre emra, kundërshtimet sllovene dhe kroate të këtij koncepti, arsyet për një kundërshtim të tillë dhe kështu me radhë).

93 Për shpalljen e shtetit më 1 dhjetor 1918 cf. më shumë në Dragoslav Janković, *Jugoslovensko pitanje i Krfska deklaracija 1917 godine* (Savremena administracija: Beograd, 1967) fq. 278-294, 455-459 (në kontekstin e shkeljes së premtive serbe të dhëna në Deklaratën e Korfuzit të vitit 1917, sipas së cilës duhej themeluar një shtet federal i sllavëve të jugut, ku sllovenët, serbet dhe kroatët do të ishin të barabartë, pas mbarimit te Luftës së Parë Botërore; për rastin e zhvlerësimit të tërësishëm të shtetësisë së Malit të Zi nga ana e serbëve në prag të themelimit të shtetit të ri në vitin 1918); Ferdo Čulinović, *Jugoslavija između dva rata*. Vol. I (JAZU: Zagreb, 1961) fq. 141-147 (autori tregon se shpallja e Mbretërisë Serbo-Kroato-Sllovene, e riemërtuar në **Mbretëri Jugosllave** nga viti 1939, është bërë nga regjenti **Aleksander Karagjorgjeviq**; zyrtarisht është konsideruar si shtet i një populli me tre emra, përkatësisht i serbëve, kroatëve dhe sllovenëve; akti i shpalljes ka pasur status **super kushteues,** nga i cili nuk ka pasur shmangie as në **Kuvendin Kushtetues** të 28 nëntorit 1920 dhe as në **Kushtetutën e Vidovdanit** të 28 qershorit 1921**;** shteti në tërësi ka qenë unitar dhe me sundim absolut të mbretit, ani se formalisht është proklamuar si monarki kushtetuese parlamentare; autori tregon se kjo ka qenë e kundërt me premtimet e dhëna në **Deklaratën e Korfuzit** të datës 20 korrik 1917, për një shtet federal të tre popujve të barabartë-serbëve, kroatëve dhe sllovenëve).

94 Me ideologjinë e **jugosllavizmit integral** dhe një administratë shtetërore tërësisht të centralizuar, diktatura e 6 janarit të vitit 1929 ka prodhuar separatizëm të fuqishëm në mesin e popujve joserb. Cf. Latinka Perović, *Kraljevina Srba, Hrvata i Slovenaca (1918–1929)/Kraljevina Jugoslavija (1929–1941): nastanak, trajanje i kraj* (Pa emër të botuesit: Beograd, 2015) fq. 14.

Me rastin e futjes së diktaturës personale, mbreti serb pat paralajmëruar rikthimin në gjendjen kushtetuese në një afat sa më të shkurtër. Kjo ka ndodhur falë situatës ndërkombëtare që nuk shkonte në dobi të hegjemonizmit serb të kohës që cenonte stabilitetin dhe sigurinë evropiane të krijuar në **Versajë.**[95] Kësisoj, më datën 3 shtator 1931, mbreti i dha fund diktaturës personale dhe riktheu në vend rendin kushtetues, por vetëm në aspektin formal. Në aspektin substancial, asgjë nuk kishte ndryshuar nga koncepti fillestar: Shteti bazohej në hegjemoninë serbe ku ende vlente teza mbi ekzistimin e një kombi unik me tre emra, i cili, nga viti 1929, cilësohej si "kombi jugosllav". Ky popull ekzistonte, megjithatë, vetëm në interpretimin serb, të cilët nuk fshihnin qëllimin e tyre për dominim të tërësishëm të popujve dhe kulturave jo serbe. Ajo që fillimisht u quajt një popull me tre emra, tani formalisht u cilësua si **kombi jugosllav**. Një hap i tillë ishte në plotni në pajtim me botëkuptimet serbe për hegjemoni ndaj tjerëve.[96] Këtë interpretim serbët e kanë edhe sot dhe asnjëherë nuk e kanë ndryshuar, gjë që shihet nga tekstet e të gjitha kushtetutave serbe të miratuara pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë në vitin 1992.

Nga okupimi i ish-**Jugosllavisë** në prill të vitit 1941, nën rrënojat e saj u krijuan disa shtete të pavarura, nën diktatin gjerman e italian, të cilat manifestonin një anti-jugosllavizëm të tërbuar si pasojë e politikave represive të **Jugosllavisë** mbretërore të dominuar nga serbët. Këto entitete shtetërore nuk u njohën nga e drejta ndërkombëtare e kohës: kjo u bë e qartë me **Kartën e Atlantikut** të datës 14 gusht 1941, dhe u konfirmua më pastaj me të gjitha dokumentet tjera të karakterit të detyrueshëm ndërkombëtar të nxjerra gjatë **Luftës së Dytë Botërore**.[97] Kjo nënkuptonte se, në aspektin juridik-ndërkombëtar, **Jugosllavia** kishte ruajtur integritetin e vet territorial, njëjtë siç kishte ndodhur me **Shqipërinë** dhe vendet tjera që kishin humbur pavarësinë e sovranitetin si pasojë e ndërhyrjes ushtarake gjatë **Luftës së Dytë Botërore**.

Ajo çfarë po ndodhte me **Jugosllavinë** gjatë kësaj lufte dhe menjëherë pas saj, në fakt, nuk ishte asgjë tjetër pos një transformim i saj në aspektin kushtetues. Ky transformim konsistonte në kalimin nga rregullimi shtetëror monarkik në një rregullimin shtetëror socialist, me ideologjinë komuniste si avangardë e re. Ideologjia komuniste po zëvendësonte **integralizmin jugosllav** të proklamuar nga mbreti serb. Integralizmi në fjalë, nuk do të bazohej më në ideologjinë serbe të dinastisë **Karagjorgjeviq**, që shihte një popull me tre emra, përkatësisht një popull dhe një kurorë jugosllave, por në ideologjinë komuniste. Në atë kohë, komunizmi pretendonte një karakter universal dhe po përhapej ndër popujt tjerët jo-rus të Evropës dhe Azisë Qendrore. Rregullimi i ri shtetëror komunist jugosllav do të zgjas aq sa vetë formacioni në fjalë, i cili më pas u përhap në katër anët e botës, në veçanti pas procesit të dekolonizimit të viteve '50-të dhe '60-të të shekullit të kaluar. Ky formacion përfundoi me kolapsin e rendit komunist në fund të viteve '90-të të shekullit të kaluar, përkatësisht me rënien e **Murit të Berlinit** në nëntor të vitit 1989, i cili merret si simbol i ribashkimit të **Evropës**.

---

95 **Franca** kishte qenë sponsori kryesor i krijimit të **Jugosllavisë** më 1 dhjetor 1918. Në literaturë quhet, jo pa të drejtë, **Jugosllavia e Versajës**. Kjo sepse roli i **Francës** kishte qenë kryesor në themelimin e këtij shteti, sikundër edhe në themelimin e **Çekosllovakisë** dhe **Polonisë**. Një politikë e tillë franceze, e përkrahur edhe nga **Britania e Madhe**, **SHBA**-të dhe vendet e tjera perëndimore ka qenë pasojë e fitimit të komunizmit në **Rusi** dhe krijimit të ish-**BRSS** dhe rrezikut që ajo krijesë paraqiste ndaj civilizimit perëndimor judeo-kristian, ashtu siç e njohim sot. Në këtë kontekst, **Jugosllavia e Versajës** ka shërbyer si një **cordone sanitaire**, pikërisht për të veçuar rolin e saj në pengimin e përhapjes poshtë në **Evropë** të forcës së pakontrolluar dhe anarkike të shtetit të ri të sovjetëve dhe ideologjisë komuniste të komisarëve rus, shtet që ishte krijuar në vitet e fundit të **Luftës së Parë Botërore**, përkatësisht më 25 tetor 1917. Cf. Antony Best, Jussi Hanhimaki, Joseph A. Maiolo, Kirsten E. Schulze, *International History of the Twentieth Century and Beyond* (Routledge: New York, 2015) fq. 48.

96 Për idetë serbe për këtë popull me tre emra, si dhe për kundërshtimin e tyre të idesë së kombit jugosllav, që fillimisht reflektonte barazinë e të gjithëve, cf. më shumë në Slobodan Jovanovic, *Ustavno pravo Kraljevine srba, hrvata i slovenaca*, fq. 45-72 & 89-91; Kombi jugosllav u krijua në vitin 1931 si vënie në jetë të idesë serbe mbi integralizmin jugosllav dhe hegjemoninë serbe, jo për të reflektuar barazinë në mes të popujve që përbënin atë shtet.

97 Fjala është për dokumentet si vijon: **Deklarata e Kombeve të Bashkuara,** datë 1 janar 1942; **Deklarata e Moskës**, datë 30 tetor 1943. dhe **Deklarata e Tehranit**, datë 1 dhjetor 1943; **Karta e Kombeve të Bashkuara**, datë 24 tetor 1945.

Në vijim të arsyeve si më sipër, diskutimi që pason ka të bëjë me zhvillimet me rëndësi kushtetuese gjatë dhe pas **Luftës së Dytë Botërore**. Në këtë kontekst, analiza jonë nis me dokumentet kryesore kushtetuese të kësaj periudhe, të cilat u listuan më sipër. Sa i përket **Kosovës**, zhvillimet kushtetuese kanë kuptim vetëm pas **amendamenteve të viteve 1969, 1971** dhe **1972** dhe miratimit të **Kushtetutës së KSAK-së** në vitin 1974 dhe pas saj.

Koha e viteve 1945-1969 ka qenë një periudhë gjatë së cilës **Kosova** nuk ka gëzuar ndonjë status të theksuar juridiko-kushtetues sepse është trajtuar si pjesë ekskluzive dhe integrale e **Republikës së Serbisë**, e cila ka qenë njësi federale e **RSFJ-së**. Identiteti kushtetues i Kosovës në kuadër të **RSFJ-së** ka marrë formë të plotë vetëm pas vitit 1974. Në këtë vit është miratuar kushtetuta e parë e Kosovës, **Kushtetuta e KSAK-së**.[98] Me këtë kushtetutë, **Kosova** fitoi një status të veçantë juridik-kushtetues, shumë të ngjashëm më atë të ish-republikave jugosllave.[99] Që nga viti 1974, **Kosova** dhe **Vojvodina** (kjo e fundit ende është pjesë autonome në Serbinë e Veriut) filluan të gëzonin statusin e autonomisë politiko-territoriale, ashtu siç e kishte predikuar **Stalini** (Joseph Vissarionovich Stalin: 1878-1953) dhe teoria e praktika komuniste.[100]

Dokumenti i parë me rëndësi kushtetuese i nxjerrë gjatë **Luftës së Dytë Botërore** është **Rezoluta mbi themelimin e Këshillit Anitifashist të Çlirimit Kombëtar të Jugosllavisë** (**KAÇKJ**) e datës 27 nëntor 1942. Kjo rezolutë, e nxjerrë në **Bihaç** të **Bosnje-Hercegovinës**, nis bazat e para të ristrukturimit kushtetues komunist të ish-Jugosllavisë në baza federale. Kjo është kështu për shkak se organizimi, platforma e punës dhe tërë veprimtaria e mëvonshme e **KAÇKJ-së** kanë qenë të dirigjuara nga komunistët. Në këtë mbledhje të **KAÇKJ-së** si më sipër u vendos që parimi federal dhe barazia e kombeve të ishin themeli i rregullimit të ardhshëm shtetëror të ish-**Jugosllavisë**. Kombësitë, siç quheshin atëherë pakicat kombëtare, fare nuk përmenden si subjekte të shtetit të ri federal. Me kombësi nënkuptoheshin pakicat kombëtare. Ky term qe farkuar nga komunistët për të treguar specifikat e sistemit komunist jugosllav. Në këtë grup hynin, në rend të parë, shqiptarët dhe hungarezët, për shkak se si pikë referimi merrej pasja e një shteti amë e që në këtë rast ishin **Shqipëria** e **Hungaria**.

Dokumenti i dytë me rëndësi kushtetuese është **Deklarata e Mbledhjes së Dytë të KAÇKJ-së** e datës 29 nëntor 1943, mbajtur në qytetin **Jajce** të **Bosnje-Hercegovinës**. Në këtë mbledhje u konstatua se gjatë **Luftës së Dytë Botërore** ka ardhur deri te ndryshimi i raportit të forcave dhe se kjo duhet të reflektohet në mënyrë të përshtatshme në lidershipin administrativ dhe shtetëror. Kjo ka ndodhur si pasojë e dështimit ushtarak të hegjemonisë serbe, gjë që ka krijuar kushtet për krijimin e një shteti demokratik në baza federative të popujve sllav të ish-Jugosllavisë. Organet e krijuara nga kjo mbledhje morën vendim që t'i ndalohet hyrja në shtet mbretit serb **Petri i Dytë Karagjorgje-**

---

98 Disa gabimisht mendojnë se **Kosova** ka pasur identitet politik dhe kushtetues para vitit 1974, përkatësisht gjatë kohës së **Përandorisë Otomane** dhe **Mbretërisë SKS/Jugosllave** (sic!). Cf. më shumë lidhur me këtë në Noel Malcolm, *Kosovo. A Short History* (New York University Press: New York, 1998), "Introduction" dhe fq. 314-333; Për natyrën e vilajeteve otomane dhe krijimin e tyre, cf. më shumë në Donald Quataret, *The Ottoman Empire 1700-1922* (Cambridge University Press: Cambridge, 2005), kapitulli 3 ("Chapter 3. The Ottoman Empire, 1683-1798"). Këta dy autorë, si dhe të tjerët, janë unanim në atë se vilajetet otomane nuk kanë pasur asnjë rëndësi kushtetuese dhe nuk kanë reflektuar përbërjen etnike, gjuhësore, kulturore dhe tjetër. Si të tilla, ato kanë qenë në vijim të konsolidimit të pushtetit të centralizuar të perandorëve otomanë. Njëjtë vlen edhe për ndarjet administrative gjatë **Mbretërisë SKS/Jugosllave**, të cilat në asnjë rast, përveç **Banovinës Kroate**, nuk kanë reflektuar strukturën etnike, fetare dhe tjetër të popullsisë. Krejt qëllimi dhe synimi i ndarjeve të tilla ka qenë që të shprish identitetet etnike, fetare dhe të tjera përmes instrumenteve kushtetuese dhe administrative.

99 Mari-Žanin Čalić, *Istorija Jugoslavije u XX veku*, fq. 319-322.

100 Për një pasqyrë të mrekullueshme të historisë kushtetuese të Kosovës para vitit 1974, Cf. Kurtesh Salihu, *Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e autonomitetit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në Jugosllavinë Socialiste* (Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mesimore i KSAK: Prishtinë, 1984) fq. 7-63; Historia e konceptit të **autonomisë politico-territoriale** ashtu siç është shtruar nga **Stalini** sqarohet tek Michael Krykov, "Self-Determination From Marx to Mao" *Ethnic and Racial Studies* Vol. 19 No. 2 (April 1996) fq. 352-377.

viq, ngjashëm siç kishte ndodhur me mbretin **Zogu I** dhe me mbretërit tjerë të vendeve ballkanike. Këto organe kanë qenë kuvendi dhe qeveria, si përfaqësues të sovranitetit të popullit dhe shtetit të Jugosllavisë, si organe të përkohshme, si dhe vetë kryesia e **KAÇKJ-së**.[101] Vendimet e mbledhjes së dytë të **KAÇKJ-së** kanë karakter të pastër kushtetues sepse me këto vendime dhe me organet e themeluara është bërë ndërprerja e kontinuitetit kushtetues me ish- Jugosllavinë e para **Luftës së Dytë Botërore**. Kontinuiteti shtetëror juridik- ndërkombëtar me shtetin pararendës, ndërkaq, ka ngelur tërësisht i paprekur deri në shkatërrimin e tij në vitin 1992.

I treti dokument me rëndësi kushtetuese është **Marrëveshja Tito-Shubashiq** e lidhur në **Beograd** më datën 1 nëntor 1944.[102] Me këtë marrëveshje, diktatori komunist jugosllav, **Josip Broz Tito** (1892-1980), në emër të qeverisë së përkohshme të **KAÇKJ-së**, dhe **Ivan Shubashiq** (1892-1955), në emër të qeverisë mbretërore jugosllave në mërgim, ranë dakord që t'i ndalohet mbretit **Petri i Dytë Karagjorgjviq** kthimi në atdhe. Ndalesa është dashur të zgjasë deri në një vendim tjetër të popujve të Jugosllavisë dhe derisa të bëhej formimi i një qeverie të përbashkët të përkohshme me një përbërje specifike. Në të njëjtën kohë nis shndërrimi i **KAÇKJ-së** në një kuvend të përkohshëm me pushtet kushtetutëbërës ("pouvoir constituant") të **Jugosllavisë Federative Demokratike**. Kjo ka ndodhur më datën 10 gusht 1945 dhe njihet si mbledhja e tretë e **KAÇKJ-së**, e mbajtur në **Beograd**. Me këtë nuk ndryshonte vendimi mbi ekzistencën politike të popujve jugosllav, grundnorma e 1 dhjetorit 1918, të cilët mbeteshin jugosllavë në planin ndërkombëtar, por vetëm identiteti kushtetues i tyre.

Dokumenti i pestë, **Deklarata mbi shpalljen e RFPJ-së,** e nxjerrë më datën 29 nëntor 1945,[103] paraqet aktin e parë të kuvendit të përkohshëm me pushtet origjiner kushtetutëbërës (**Kuvendi Kushtetues**). Ai kuvend përbëhej nga dy dhoma: **Dhoma Federative** dhe **Dhoma e Popujve**. Ato dhoma kishin dalë nga zgjedhjet e nëntorit 1945 për Kuvendin Kushtetues. Deklarata përfundimisht abrogon monarkinë, kurse mbreti serb **Petri i Dytë** privohet nga çdo e drejtë lidhur me Jugosllavinë, si në planin e brendshëm ashtu dhe në atë ndërkombëtar.[104] Në esencë, **shpallja e regjimit republikan** ka nënkuptuar shkëputje të tërësishme dhe rrënjësore me subjektivitetin juridik-kushtetues të Jugosllavisë mbretërore, që kishte ekzistuar gjatë viteve 1943-1945 si pasojë e rrethanave ndërkombëtare nën të cilat ishte gjetur **Jugosllavia**. Deklarata, përveç kësaj, proklamonte barazinë e të gjithë popujve të Jugosllavisë, të cilët thuhej se me vullnet të lirë kishin vendosur të jetojnë të bashkuar në Jugosllavi. Sa u përket **pakicave kombëtare**, siç ishin **hungarezët** dhe **shqiptarët**, as që bëhej fjalë sepse nuk konsideroheshin popuj me të drejtë për vetëvendosje të jashtme. Sistemi politik jugosllav tani e tutje në tërësi dhe në mënyrë efektive u bë njëpartiak, përkatësisht sistem në të cilin garantohej në mënyrë efektive supremacia (epërsia) e partisë komuniste dhe ideologjisë së saj.[105]

Me **Kushtetutën e RFPJ-së,** e miratuar më 31 janar të vitit 1946, si dokument i gjashtë me radhë, konfirmohet sanksionimi i tërësishëm i supremacisë (epërsisë) së **Partisë Komuniste Jugosllave** (PKJ).[106] Në të njëjtën kohë, ky dokument paraqet kushtetutën e parë të Jugosllavisë komuniste, në

---

101 Për komentet, cf. më shumë në Dusan Papadopolos, *AVNOJ i narodno oslobodilačka borba u Bosni i Hercegovini: 1942-1943: materijali sa naučnog skupa održanog u Sarajevu 22. i 23. novembra 1973. godine* (Rad: Beograd, 1974).

102 Për tekstin e plotë, shih në internet: http://www.arhivyu.gov.rs/active/sr-latin/home/glavna_ navigacija /leksikon jugoslavije/konstituivni_akti_jugoslavije.html (shikuar në mars 2022); Për komentet, cf. në Wayne S. Vucinich, Jozo Tomasevich, *Contemporary Yugoslavia: Twenty Years of Socialist Experiment* (University of California Press: Berkeley and Los Angeles,1969) fq. 105, 108, 121.

103 Për komentet, Cf. Branimir M Janković, *The Balkans in International Relations* (Mcmillan Press: London, 1988) fq. 180-181.

104 Në aspektin e pluralizmit politik, kjo deklaratë shënon kalimin e Jugosllavisë në sistemin kushtetues njëpartiak: tani e tutje nuk lejohet më ekzistimi i asnjë partie politike përveç partisë komuniste jugosllave. Cf. Mari-Žanin Čalić, *Istorija Jugoslavije u XX veku*, fq. 219.

105 Cf. Mari-Žanin Čalić, *Istorija Jugoslavije u XX veku* fq. 219.

106 Ibid. fq. 220.

tërësi e modeluar sipas **Kushtetutës së Bashkimit të Republikave Sovjetike Socialiste** (BRSS) të vitit 1936. Njëjtë ka qenë rasti me Shqipërinë dhe kushtetutën e parë të saj pas Luftës së Dytë Botërore. Kjo vërehet, në veçanti, në rolin dhe pozitën e organeve shtetërore në nivel federal, të cilat reflektonin një centralizëm të plotë të pushtetit, tipik për një vend stalinist, ku organet e njësive federale iu nënshtroheshin tërësisht organeve federale, në secilin aspekt të organizimit të pushtetit shtetëror[107] Kushtetuta përcaktoi që kufijtë republikanë do të caktoheshin më pastaj, pasi të merrej pëlqimi i republikave federale, kurse **pakicat fituan disa të drejta kulturore dhe gjuhësore.**

Ligji Kushtetues i vitit 1953, paraqet dokumentin e shtatë me rëndësi të madhe kushtetuese, ani se nuk ka qenë një kushtetutë e plotë. Ndryshimet e thella politike dhe shoqërore të viteve 1946-1953 kanë pasur për pasojë nxjerrjen e këtij ligji, me të cilin Kushtetuta e vitit 1946 është ndryshuar në masë të madhe. Në rend të parë, pushteti tani e tutje nuk i takon popullit, por kategorisë së re të popullit punues, kurse Jugosllavia definohet si shtet federativ socialist dhe demokratik i popujve sovranë dhe të barabartë. **Pakicat kombëtare** sërish nuk fitojnë ndonjë të drejtë shtesë krahasuar me periudhën pararendëse.

Dhjetë vjet pas nxjerrjes së **Ligjit Kushtetues**, më datën 7 prill 1963, u nxor **Kushtetuta e RSFJ-së,** emër i ri kushtetues të cilin do ta mbajë deri në shpërbërjen e vet përfundimtare në pranverë të vitit 1992. Si simbol i shkëputjes nga rruga staliniste e planifikimit shtetëror të ekonomisë dhe dominimit të shtetit në të gjitha sferat e jetës, kjo Kushtetutë më tutje forcoi modelin shtetëror të vetëqeverisjes jugosllave të instaluar më 1953, si një model e ri i qeverisjes në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Ndryshimi i emrit kushtetues të shtetit pati refleksione edhe në definimin e tij: tani e tutje **RSFJ** cilësohet si një shtet federativ i popujve të barabartë të bashkuar me vullnet dhe si një bashkësi socialiste demokratike e bazuar në pushtetin e popullit punues dhe vetëqeverisjen.[108] Me këtë kushtetutë, **Kosova** fiton një ngritje në statusin e saj juridik-kushtetues: nga një **rreth autonom** shndërrohet në një krahinë autonome, ani se me të drejta më të vogla se **Vojvodina**, e cila gjithashtu ishte në kuadër të Serbisë, që konsiderohej si njësi federale (krahas **Bosnje-Hercegovinës, Kroacisë, Maqedonisë, Malit të Zi** dhe **Sllovenisë**).

Amendamentet në Kushtetutën e vitit 1963 përbëjnë hyrje në revidim të tërësishëm të kësaj të fundit. Këto amendamente janë miratuar përgjatë viteve 1967, 1968 dhe 1971. Me to është forcuar roli i republikave dhe i krahinave autonome. Këto të fundit thuajse janë barazuar në statusin e tyre juridik-kushtetues me republikat federale, kurse vetë Federata u bë një forum konsensusi në mes të republikave dhe krahinave. Tani e tutje republikat dhe krahinat bëhen aktore kryesore të **RSFJ-së** ashtu që çdo veprim i Federatës për çështjet kryesore i nënshtrohej marrëveshjes konsensuale në mes të republikave dhe krahinave.[109]

Kushtetuta e RSFJ-së e vitit 1974 nuk bënë gjë tjetër pos që sanksionon të arriturat e kryera me amendamentet në Kushtetutën e vitit 1963, pra, forcon rolin e republikave dhe krahinave, duke dobësuar në të njëjtën kohë rolin e Federatës. Çdo gjë në nivel federal, tani e tutje duhej të realizohej përmes marrëveshjes në mes të republikave dhe dy krahinave autonome, pra jo në mes të popujve siç pretendonin serbët.[110] Kjo fizionomi u reflektua edhe në organet e reja

[107] Në literaturë, ky dokument cilësohet si një tekst i një vendi komunist që për herë të parë në kuadër të sistemit komunist të kohës ka filluar një interpretim më liberal të doktrinës marksiste–leniniste rreth ekonomisë dhe proceseve shoqërore: vetëqeverisja dhe decentralizimi ishin dy komponentë të komunizmit jugosllav, të cilat i jepnin sistemi politik dhe kushtetues një ”fytyrë humane“ krahasuar me vendet tjera të bllokut komunist. Cf. Dimitar Bechev, *RivalPower. Russia's Influence in South East Europe* (Yale University Press: New Haven and London, 2017) fq. 25-26.

[108] Cf. Mari-Žanin Čalić, *Istorija Jugoslavije u XX veku*, fq.234-252.

[109] Ibid., fq. 284-285 & 293-313.

[110] Cf. Mari-Žanin Čalić, *Istorija Jugoslavije u XX veku*, fq. 320-322.

kushtetuese: **Kuvendi i RSFJ-së** u bë dydhomësh, njëra dhomë për përfaqësim të popullit punues vetëqeverisës, të qytetarëve dhe shtresave të tjera, kurse dhoma tjetër shërbente si përfaqësuese e republikave dhe krahinave në mënyrë të barabartë. Në bazë të kësaj kushtetute, **Kosova** fiton të drejtën e **nxjerrjes së kushtetutës** së vet **në mënyrë autonome**, njëjtë siç e kishin gëzuar këtë të drejtë republikat jugosllave.

Përgjatë viteve '80-të të shekullit të kaluar, **Kushtetuta e RSFJ-së e vitit 1974** ka pësuar disa amendamentime. Reforma kushtetuese ndërmjet viteve 1981-1988, e realizuar përmes amendamenteve I-VIII dhe IX-XLVIII nuk ka qenë e natyrës së atillë sa të prek apo ndryshojë **identitetin kushtetues** të shtetit jugosllav. Ka qenë ardhja në pushtet e diktatorit serb, **Sllobodan Milosheviq** në vitin 1986, ajo që ka ndryshuar çdo gjë në nivel jugosllav: nga kjo kohë, në **Serbi** u hap "kutia e Pandorës" së nacionalizmit serb, i cili provokoi fuqishëm edhe nacionalizmat tjerë, në rend të parë atë kroat dhe slloven, por edhe nacionalizmat që deri atëherë kishin qenë të fjetur (maqedonët, myslimanët boshnjakë, hungarezët etj). Në mesin e shumë sloganeve në retorikën nacionaliste serbe të kësaj kohë ka qenë rikthimi i shtetësisë së **Serbisë**, të cilën serbët e konsideronin se e kishin humbur me nxjerrjen e **Kushtetutës së RSFJ-së të vitit 1974**. Kjo nënkuptonte prishjen e baraspeshës kushtetuese dhe politike në nivel federal dhe, në fund, edhe prishjen e shtetit të përbashkët. **Serbia** e diktatorit **S. Milosheviq**, përkundër gjithë këtij rreziku për prishjen e këtyre balancave, nisi një luftë frontale kundër të gjithëve me qëllim të ndryshimit të raportit të forcave në favor të saj: së pari rrënoi qeveritë kushtetuese në **Mal të Zi** dhe **Vojvodinë**, pastaj iu vërsul **Kosovës**, duke i kthyer për vete votat e katër njësive federale, me qëllim që më pastaj të kryente ndryshimet radikale kushtetuese në nivel federal. Një sjellje e tillë rrezikonte kroatët, maqedonasit dhe boshnjakët, përveç që bëri riintegrimin tërësisht të dhunshëm të **Kosovës** në sistemin kushtetues serb, i cili u krye në shtator të vitit 1990. Kjo u pasua, pas pak muajsh me sulme ushtarako-policore dhe me paramilitarë kundër sllovenëve, kroatëve dhe myslimanëve. Në ndërkohë, në **Kosovë** ai vuri gjendjen e përhershme të jashtëzakonshme, e cila zgjati deri në çlirimin e Kosovës më 10 qershor 1999 nga trupat e **NATO-s**, të ndihmuara nga forcat e **Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK)**.

Të gjitha këto ngjarje që lidhen me ndryshimet e fundit kushtetuese të Kushtetutës së vitit 1974 kanë ndodhur me intensitet të shtuar përgjatë viteve 1989-1990. Në këto dy vite të gjitha kushtetutat e republikave dhe krahinave pësuan ndryshime rrënjësore, të cilat nuk përputheshin fare me **Kushtetutën e RSFJ-së** të vitit 1974, për shkak se përmbanin dispozita që ishin jashtë parimeve dhe normave të saj, si në formë ashtu dhe në përmbajtje. Kjo rrugë kundërkushtetuese e rrënimit të shtetit të fundit të sllavëve të jugut (me përjashtim të bullgarëve), në mënyrë simbolike nis me **Kosovën**, aty ku kishte nisur kriza e atij shteti në fillim të viteve '90-të të shekullit të kaluar. Kjo sepse, me ardhjen e tij në pushtet, diktatori serb mori si detyrë të shenjtë reintegrimin e Kosovës dhe Vojvodinës në Serbi në të gjitha aspektet: politike, shoqërore dhe ekonomike, kulturore dhe në aspekte të tjera. Kjo, në fakt, përbënte realizim të politikës hegjemoniste serbe të skicuar në **Memorandumin e ASSHA-së** të vitit 1986 (Memorandumi, një dokument famëkeq të cilin, në fakt, vetë lideri serb **Sllobodan Millosheviq** (Slobodan Milošević: 1941-2006) e kishte kundërshtuar fillimisht.[111] Esenca e Memorandumit ishte prishja e balancave dhe parametrave kushtetuese të përcaktuar me Kushtetutën e vitit 1974: prishja e balancave të viti 1974, në mënyrë të qartë ishte bërë synim serb në Memorandum, i cili i paraqiste serbët si viktima të popujve tjerë të ish-Jugosllavisë, në rend të parë si viktima të shqiptarëve dhe kroatëve, të cilët cilësoheshin si popuj

[111] Për tesktin e plotë të Memorandumit, Cf. *Serbian Academy of Arts and Sciences (SANU) Memorandum 1986*. Në internet: http:// chnm. gmu. edu/ 1989/ items/sHow/674 (shikuar në dhjetor 2021); *Memorandum Srpske Akademije Nauka i Umetnosti (nacrt) Jesen 1986.* Në internet:http://www.helsinki.org.rs/serbian/doc/mem orandum%20sanu. pdf (shikuar në dhjetor 2021); Për komentet e tij, cf. Christina Morus, "The SANU Memorandum: Intellectual Authority and the Constitution of an Exclusive Serbian 'People'" *Communication and Critical/Cultural Studies* Vol. 4 Issue 2 (2007) fq. 142-165; Mari-Žanin Čalić, *Istorija Jugoslavije u XX veku*, fq. 340-341.

agresivë dhe fajtorë për "gjenocidin kundër serbëve".[112]

Në ndërkohë që sulmi ndaj **Vojvodinës** edhe mund të kalonte pa ndonjë pengesë serioze, për shkak të ndërrimit radikal të përbërjes etnike të popullsisë atje, në **Kosovë** gjendja paraqitej krejt më ndryshe: reiintegrimi i **Kosovës** në **Serbi**, sipas ideve të **Memorandumit të ASSHA-së**, mund të bëhej vetëm me përdorim të dhunës në një shkallë të gjerë dhe në mënyrë sistematike. E njëjta gjë vlente edhe për **Kroacinë** dhe **Bosnje-Hercegovinën**, për të cilat Memorandumi thoshte se kanë në gjirin e tyre serbë që janë të persekutuar si qytetarë të rendit të dytë. Ky qëndrim u përkthye shumë shpejt në përdorim të dhunës, atëherë kur nisi zbatimi i tij në Kroaci dhe Bosnje – Hercegovinë gjatë viteve 1991-1995. Në vazhdën e realizimit të këtyre qëllimeve memorandumiane duhen parë edhe ndryshimet kushtetuese në Kosovë dhe brutaliteti shtetëror i përdorur kundër shqiptarëve me rastin e miratimit të tyre nga **Kuvendi i Kosovës** më datën 23 mars 1989, si dhe dhuna që vazhdoi të përdorej kundër kroatëve dhe boshnjakëve viteve në vijim.

Me këto amendamente kushtetuese, të kryera me dhunë në rrethanat e gjendjes së jashtëzakonshme, **Kosova** dha pëlqimin e vet për ndryshimet kushtetuese me të cilat Serbisë i njihej e drejta për ta futur **Kosovën** nën dominimin e vet shtetëror në të gjitha fushat juridiko-politike, kushtetuese, socio-ekonomike, kulturore etj. Me dhënien e këtij pëlqimi nga ana e **Kosovës**, **Serbia** miratoi amendamentet kushtetuese, në veçanti amendamentin **XLVII** në **Kushtetutën e Republikës së Serbisë** të vitit 1974. Me këtë hap **Kosova** humbi të drejtën e vetos në ndryshimin e **Kushtetutës së Serbisë**, të cilën e kishte gëzuar në bazë të **Kushtetutës së RSFJ-së** të viti 1974, veto që përbënte një garancion për krahinat autonome kundër dominimit dhe hegjemonisë serbe. Me këtë pëlqim të dhënë, **Kosovës** iu hapën rrugët për reiintegrim të dhunshëm në tërësi në sistemin juridik-kushtetuese, socio-politik, ekonomik, kulturor dhe tjetër të **Republikës së Serbisë**. Kjo u pa një vit më vonë kur u miratua **Kushtetuta e Serbisë** (shtator 1990): me këtë kushtetutë statusi i **Kosovës** u reduktua në status të një autonomie lokale, duke përjashtuar, tani e tutje, çdo ndikim të shqiptarëve në vendimmarrje lidhur me punët e **Kosovës**.[113]

Miratimi i amendamenteve të datës 23 mars të vitit 1989, pati për pasojë reagimin e shqiptarëve në gjysmën e parë të vitit 1990: më 2 korrik u shpall **Deklarata e Pavarësisë së Kosovës,** kurse

[112] Në literaturë është vërejtur se reformat kushtetuese në nivel federal gjatë viteve 1967-1971, të cilat në fund u kurorëzuan me autonominë e gjerë politiko – territoriale të **Kosovës** dhe **Vojvodinës,** në dëm të Serbisë, ishin rezultat i koncesioneve të diktatorit komunist **Tito** dhe luftës së tij të brendshme për të menaxhuar republikat jugosllave, në veçanti **Serbinë**. Kjo e fundit, nga komunistët jugosllavë, në veçanti nga diktatori **Tito**, por edhe nga sllovenët e kroatët, është parë si një republikë me tendenca të theksuara hegjemoniste. Kjo përbënte një hendikep për serbët dhe **Serbinë,** në veçanti pas rënies së udhëheqësit komunist federal serb, **Aleksandar Rankoviq**, në vitin 1966, që në rrethanat e klimës së viteve 1967-1971 paraqiste favor për **Kosovën** dhe **Vojvodinën**. Këto koncesione ndaj **Kosovës** dhe **Vojvodinës** dhe këtë situatë jo të favorshme, serbët e përjetuan si frustrim. Cf. më shumë për këtë në Dejan Jović, *Yugoslavia: A State that Withered Away* (Purdue University Press: West Lafayette, Indiana, 2009) fq. 99-105; Ky frustrim serb do të manifestohet për herë të parë në formë të hapur përmes të a.q. **Libri i Kaltërt,** pak vite pas nxjerrjes së kushtetutave të vitit 1974 të të gjitha niveleve dhe, më pastaj, në mesin e viteve '80 të shekullit të kaluar përmes **Memorandumi të ASSHA**. Në fakt, shumë ide, përfundime, analiza dhe rekomandime të **Memorandumit** e kanë origjinën te **Libri i Kaltërt** i vitit 1977. Në këto dy dokumente sulmohej ashpër statusi i dy krahinave autonome, të cilat shiheshin si shkaku i krejt të keqes së Serbisë, flitej për diskriminimin e serbëve nga ana e shqiptarëve, kroatëve dhe popujve tjerë, flitej për synimin e reintegrimit të serbëve në një shtet të vetëm dhe kështu me radhë. Fokusi primar i këtyre dy dokumenteve, megjithatë, ka qenë **Kosova** dhe shqiptarët dhe pozita e tyre e favorshme sipas Kushtetutës së vitit 1974, për të cilën e fajësonin diktatorin komunist **Tito** sepse, sipas serbëve, ai me qëllim kishte bërë koncesionet ndaj Kosovës për ta dëmtuar Serbinë dhe serbët. Cf. më shumë për raportin e brendshëm të forcave në mes të republikave dhe krahinave jugosllave, **Librin e Kaltërt** dhe lidhshmërinë e tij me **Memorandumin e ASSHA** në këto studime: Nebojša Popov (ed.), *The Road to War. Trauma and Catharsis* (CEU Press: Budapest, 2000) fq 29-31; Ana S. Trbovich, *A Legal Geography of Yugoslavia's Disintegration*, fq. 195- 204; Jasna Dragović-Soso, "*Saviours of the Nation": Serbia's Intellectual Opposition and the Revival of Nationalism* (C. Hurst & Co. Ltd.: London, 2002) fq. 177-193.

[113] Liljana Slavnić, *Ustavno pravo* (Privredna Akademija: Novi Sad, 2007) fq. 134- 135, 385-387.

më 7 shtator 1990 u miratua **Kushtetuta e Kaçanikut**. Përgjigja serbe qe shumë e ashpër: në qershor dhe korrik të vitit 1990, u nxorën dy ligje që i jepnin të drejtën **Republikës së Serbisë** për të vepruar në situatat e gjendjes së jashtëzakonshme në tërë territorin e saj, përfshirë **Kosovën**, me qëllim të sigurimit të ligjshmërisë, kushtetutshmërisë si dhe, siç thuhej atëbotë, respektimit të të drejtave dhe lirive njerëzore e të demokracisë. Përveç kësaj, këto ligje rrënuan tërësisht të gjitha institucionet kosovare të themeluara në Kosovë, rrënim që kishte nisur në pranverë të vitit 1989 me qëllim të detyrimit të **Kosovës** që të jepte pëlqimin në amendamentet e sipërcekura kushtetuese me të cilat **Kosova** u zhvesh në tërësi nga çdo e drejtë autonome që e kishte gëzuar sipas kushtetutave të **RSFJ-së** dhe **KSAK-së** të vitit 1974. Këto dy ligje, me fjalë të tjera, nuk bënin asgjë tjetër pos që në tërësi abrogonin autonominë e vjetër të gëzuar nga kosovarët si dhe rrënimin total të institucioneve të themeluara në mënyrë autonome nga Kosova. Kjo bëhej në kushtet e një gjendje të jashtëzakonshme, pra në gjendje të jashtëzakonshme po abrogoheshin nga ana e Serbisë të gjitha institucionet kosovare të themeluara sipas kushtetutave të **RSFJ-së** dhe **KSAK-së** të vitit 1974.[114] Me këtë, në mënyrë formale-juridike, **Kosova** po futej në sundim të drejtpërdrejt nga Beogradi në stilin e regjimeve koloniale të instaluara në mënyrë brutale nga ana e shteteve metropole.[115]

Në **Serbi**, këta hapa u cilësuan si një sukses i madh sepse, siç thuhej, **Serbia** më në fund u bë shtet normal dhe anëtar i barabartë i **RSFJ**-së.[116] Më këtë qasje, u mor vesh, nuk pajtoheshin asnjëra prej ish-republikave jugosllave (përveç **Malit të Zi**, satelitit të **Serbisë** së asaj kohe, kurse **Vojvodina** nuk kishte arritur fare të rezistojë si pasojë e raportit të brendshëm të forcave në favor të serbëve lokal). Amendamentimi i kushtetutave republikane në kundërshtim të hapur me **Kushtetutën e RSFJ të viti 1974** vazhdoi edhe më fort nëpër republikat tjera, si reagim ndaj politikave agresive të Serbisë (dhe Malit të Zi).

Përveç si më sipër, ekzistojnë edhe disa tekste kushtetuese serbe që kanë pasur një efekt të drejtpërdrejt në Kosovë dhe historinë e saj kushtetuese dhe historinë tjetër. E kemi fjalën për **Kushtetutën e RFJ-së** të vitit 27 prillit 1992, e njohur si **Kushtetuta e Zhablakut** (sipas qytezës në malet piktoreske të **Durmitorit** në veri të Malit të Zi), **Kartën Kushtetuese** të vitit 2003 dhe, së fundi, **Kushtetutën e Serbisë** të vitit 2006, pra të Serbisë si shtet sovran dhe i pavarur, si njëri prej shteteve të reja të dala nga rrënojat e ish-Jugosllavisë.

Kur u nxor **Kushtetuta e Serbisë** në shtator të vitit 1990, **Kosova** fare nuk figuronte si entitet me të drejtë të vetos apo ndonjë të drejtë tjetër që kishte gëzuar në të kaluarën sipas dy kushtetutave të vitit 1974, të **RSFJ-së** dhe **KSAK-së**: me amendamentet në Kushtetutën e RS të Serbisë të datës 28 mars 1989, amendamentet IX-XLIX, u ndryshua procedura për ndryshimin e **Kushtetutës së RSS-së**: tani e tutje më nuk kërkohej pëlqimi i **Kosovës** dhe **Vojvodinës**. Kjo u bë e mundur pasi që më datën 23 mars 1989, autonomia e Kosovës, e garantuar sipas **Kushtetutës së RSFJ-së** të 1974, ishte ndryshuar me dhunë nga ana e **Serbisë**.[117] Ky ndryshim i pozitës kushtetuese në nivel të **RSFJ-së**, i kryer përmes rrënimit të autonomisë së **Kosovës** me datën 23 mars 1989, prishi balancat në nivel federal dhe shkaktoi reagim zinxhiror të republikave ish-jugosllave në veri të vendit dhe gjetiu.

---

114 Liljana Slavnić, *Ustavno pravo* (Privredna Akademija: Novi Sad, 2007), fq. 386.

115 Cf. më shumë në Mirosal Cerar, "Slovenia's Constitutional Court Within the Separation of Power". Në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Përspective* (Kluwer Law International: The Hague, 2010) fq. 213-245, në fq. 213, fusnota nr. 2; për zhvillimet kushtetuese në ish-Jugosllavi gjatë përiudhës komuniste, Cf. më shumë në Jovan Gjorgjeviq, *E drejta kushtetuese*, 75-114; Dimitrije Kulić, *Ustavno Sudstvo u Svetu* (Naša Reč: Leskovac, 1972), fq. 157-190.

116 Liljana Slavnic, *Ustavno pravo,* fq. 385-386.

117 Kuvendi i **KSAK** në këtë ditë ka dhënë pëlqimin për ndryshimin e **Kushtetutës së RSS** me të cilin pëlqim autonomia e **Kosovës** dhe **Vojvodinës** në tërësi shuhet, ashtu që më nuk ka nevojë të kërkohet asnjë pëlqim prej tyre për ndryshime kushtetuese në **Serbi.**

Vitin në vijim, **Kosova** menjëherë shpall pavarësinë e vet më datën 2 korrik 1990, kurse më 7 shtator 1990 nxjerr **Kushtetutën e Kaçanikut**, për të cilën flasim më poshtë. Republika e Serbisë ende para nxjerrjes në shtator të vitit 1990 të kushtetutës së re, reagon ashpër ndaj këtyre hapave të kosovarëve dhe shkatërroi çdo institucion të mbetur të Kosovë (kuvendin, organin ekzekutiv, gjykatat e rregullta dhe **Gjykatën Kushtetuese të KSAK-së**, si dhe çdo institucion tjetër), duke çimentuar masat e gjendjes së jashtëzakonshme, të cilat, **de facto,** kanë zgjatur deri në çlirimin e Kosovës më 10 qershor 1999. Kjo nënkupton se **Kushtetuta e Republikës së Serbisë** e shtatorit të vitit 1990, edhe në aspektin formal, abrogon çdo element të autonomisë së Kosovës: tani e tutje, **Kosova** nuk ka asnjë kompetencë kushtetuese dhe ligjvënëse, duke u kthyer kësisoj në gjendjen e viteve 1945-1969, kur dominohej e administrohej **de facto** dhe **de jure** nga regjimi në **Beograd**.

Me **Kushtetutën e Zhabljakut** të vitit 1992, nuk ndryshohet asgjë në statusin e **Kosovës**: vendi vazhdon të qeveriset në mënyrë të centralizuar dhe më dorë të hekurt nga regjimi serb i Beogradit i instaluar me dhunë në vend, një lloj sistemi i sundimit të guvernatorëve i kohës koloniale ku popullsia lokale shërben vetëm si objekt për të vepruar mbi të me tërë ashpërsinë dhe brutalitetin shtetëror. Në këtë periudhë shqiptarët në tërësi u përjashtuan nga puna dhe jeta publike, nisin një sistem paralel të jetës publike, të vetorganizimit politik mjaft civilizues sipas çdo kriteri civilizues dhe tjetër. Pas lidhjes së **Marrëveshjes së Beogradit** të 14 marsit 2002, ndryshon emri nga **RFJ** në **USMZ**. Bazuar në këtë marrëveshje, më datën 4 shkurt 2003, është nxjerrë **Karta Kushtetuese** me të cilën u parashikua themelimi i organeve të përbashkëta të bashkësisë shtetërore dhe çdo aspekt tjetër i marrëdhënieve në mes të **Serbisë** dhe **Malit të Zi**. Si Marrëveshja ashtu dhe Karta sanksiononin një marrëdhënie krejtësisht konfederale në mes të këtyre dy republikave ish-jugosllave. Në këtë kohë, me **Serbinë** kishin ngelur vetëm malazezët dhe përfaqësuesit nga **Kosova** e **Vojvodina**, të cilave **Serbia** ua kishte hequr çdo autonomi në vendimmarrje.[118]

Serbia i shpallte të tjerët që fitonin pavarësinë si pasojë e dhunës serbe si secesionistë, kurse veten e shpallte si ruajtëse dhe trashëgimtare të vetme legale dhe legjitime të ish-Jugosllavisë, si në planin ndërkombëtare ashtu dhe në aspektin kushtetues. Qasja serbe, që sot e kësaj dite insiston në kontinuitetin shtetëror juridiko-ndërkombëtar dhe kushtetues me ish-Jugosllavinë, bazohet në disa premisa. Kjo e fundit, premisa lidhur me kontinuitetin kushtetues, bazohet në premisën që lidhet me mënyrën e formimit të **RFJ-së** më datën 27 prill 1992: serbët besonin se respektimi i formës, me kuptim respektimi formal i **Kushtetutën e RSFJ-së** të vitit 1974 gjatë krijimit të RFJ-së, mjaftonte që t'i bënte ata trashëgimtar të vetëm kushtetues të ish-RSFJ-së. Kjo rrethanë, gjithnjë sipas serbëve, ka mjaftuar që tjerët të shpallen si secesionistë pa asnjë të drejtë lidhur me të drejtat dhe asetet e shtetit pararendës. Premisat lidhur me kontinuitetin shtetëror juridiko-ndërkombëtar të Serbisë me ish- Jugosllavinë, ndërkaq, gjithnjë sipas serbëve, konsistojnë në sa vijon:

- e para, serbët që nga fillimi i jetës së **ish-Jugosllavinë** më 1 dhjetor 1918 e deri në shpërbërjen e saj më 27 prill 1992, kanë qenë komb konstituiv (themelues) i atij shteti;
- e dyta, e drejta për vetëvendosje ka mund t'ju takojë vetëm popujve konstituivë (themelues) të **ish-Jugosllavisë**, të cilët, pas federalizmit të saj më 1945, kanë qenë si vijon: serbët, kroatët, sllovenët, maqedonasit, malazezët dhe, pas mesit të viteve '70-të të shekullit të kaluar, edhe boshnjakët myslimanë;
- e treta, secesioni si forma kryesore dhe më sublime e realizimit të së drejtës për vetëvendosje

[118] Për këndvështrimin serb të këtyre vendimeve të natyrës krejt politike të **Gjykatës Kushtetuese të RSFJ**, Cf. komenetet e kryetarit të fundit të asaj gjykate, serbit **Milovan Buzadzic**, në Milovan Buzadzić, *Secesija bivsih jugoslovenskih republika u svetlosti odluka Ustavnog dusa Jugoslavije* (NIU, Službeni list SRJ: Beograd, 1994), fq. 57-65 (pikëpamjet e tij janë shprehur në fjalimin e tij para Kuvendit të RSFJ, në cilësinë e tij formale si kryetar i **Gjykatës Kushtetuese të RSFJ**, me të cilin raportonte për gjendjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në nivel jugosllav, gjendje të cilën e cilësonte si dramatike dhe në tërësi e orientuar kah rrënimi i tërësishëm i rendit juridik-kushtetues dhe lufta civile).

nuk u ka takuar republikave (lëre më krahinave autonome që cilësoheshin se entitete të pakicave kombëtare), por vetëm kombeve konstituivë (themelues); për pasojë, ata që iknin nga **ish-Jugosllavia,** duheshin trajtuar si secesionistë, kurse ata që donin të rrinin në të, si titullarë që gëzonin të drejtën për vazhdim të kontinuitetit shtetëror juridiko- ndërkombëtar të shtetit pararendës, **ish- Jugosllavisë**;

- e katërta, serbët fare nuk e kishin parasysh se edhe republikat tjera që po pavarësoheshin nga ish-Jugosllavia, kishin nxjerrë dokumentet e tyre kushtetuese, pikërisht duke u bazuar formalisht në **Kushtetutën e RSFJ-së** të vitit 1974;
- e pesta, e drejta për të gëzuar statusin e shtetit që ka kontinuitet shtetëror juridik-ndërkombëtar dhe juridik-kushtetues me shtetin pararendës, në këtë rast me ish-Jugosllavinë (1918-1992), buronte nga dy fakte historike themelore: faktit se dy shtetet pararendëse të cilat kishin themeluar **ish-Jugosllavinë**, **Mbretëria e Serbisë** (1882-1918) dhe **Mbretëria e Malit të Zi** (1910-1918), gjithnjë sipas serbëve, përbënin shumicën e territorit dhe të popullsisë konstituive (themeluese) të shtetit pararendës, pra të **ish-Jugosllavisë**, dhe, faktit tjetër, se **ish-Jugosllavia** kishte qenë anëtare e OKB-së, bile anëtare me të drejtat e njërit prej themeluesve të saj në **San Francisko** në vitin 1945;
- e gjashta, anëtarësimi në **OKB** i ish-Jugosllavisë paraqet një të drejtë absolute për t'i cilësuar tjerët si secesionistë, pa asnjë të drejtë të tyre për të trashëguar atë si shtet pararendës. Këtë qasje serbët e argumentojnë, dje dhe sot, me të drejtën e **Indisë** që kishte trashëguar të drejtën e anëtarësimit në **OKB** me rastin e shkëputjes nga ajo të **Pakistanit** dhe **Bangladeshi**t. Kjo analogji me **Indinë**, megjithatë, nuk qëndron aspak në pikat themelore: pavarësimi i shteteve që dikur përbënin atë që njihej si **India Britanike** (**Pakistani, Bangladeshi** dhe **India** e sotme) ka ndodhur në kontekstin kolonial, jo në kontestin e shpërbërjes së një shteti të pavarur dhe sovran, siç është shpërbërja e **ish-Jugosllavisë**. Jo vetëm procesi i dekolonizimit e bënë të ndryshëm esencialisht rastin e Indisë me **ish-Jugosllavinë**: me rastin e shpërbërjes së **Indisë Britanike** ka eksituar një marrëveshje e tri shteteve të reja si më sipër për t'ia pranuar vetëm njërit prej tyre, **Indisë**, kontinuitetin shtetëror me shtetin pararendës, **Indinë**, siç kishte ndodhur edhe në disa raste tjera përgjatë historisë kur iu është njohur nga ana e bashkësisë ndërkombëtare kontinuiteti shtetëror vetëm njërit prej shteteve të reja të dala nga shpërbërja e shtetit pararendës. Të tilla raste kanë qenë **Austria, Turqia** dhe **ish-BRSS-ja** pas **Luftës së Parë Botërore**, të cilave iu njoh statusi i vazhdimësisë me shtetin pararendës, përkatësisht me **Austro- Hungarinë**, **Perandorinë Otomane** dhe **Rusinë Cariste**. Kjo ka ndodhur edhe pas mbarimit të Luftës së Ftohtë kur **Federatës së Rusisë** iu njoh e drejta për vazhdimësi shtetërore me ish-BRSS-në. Krejt këto raste, thënë ndryshe, kanë ndodhur sepse ka ekzistuar një konsensus në bashkësinë ndërkombëtare sa i përket fizionomisë së shteteve të reja të krijuara nga një shtet pararendës, tanimë i shpërbërë (**Perandoria Austro – Hungareze, Perandoria Otomane, Rusia Cariste** dhe **ish-BRSS-ja**.[119]

U mor vesh, këtë qasje serbe mbi kontinuitetin shtetëror juridiko-ndërkombëtar dhe juridiko-kushtetues që u diktua deri këtu, nuk e ka pranuar askush nga bashkësia ndërkombëtare dhe asnjëri nga ish-shtetet e reja të krijuara nga rrënojat e **ish-Jugosllavisë**.

[119] Milovan Buzadzić, *Secesija bivsih jugoslovenskih republika u svetlosti odluka Ustavnog dusa Jugoslavije* (NIU, Službeni list SRJ: Beograd, 1994), fq. 275-281 (ky autor, në cilësinë e kryetarit të fundit të **Gjykatës Kushtetuese të RSFJ-së**, komenton vendimet e kësaj gjykate lidhur me çështjen e kontinuitetit shtetëror juridiko-ndërkombëtar dhe juridiko-kushtetues të ish Jugosllavisë; mendimi i tij përfaqëson standardin serb të arsyetimit të këtyre aspekteve të shpërbërjes së ish Jugosllavisë; se kjo është kështu qartë shihet nga arsyetimi i këtyre vendimeve të **Gjykatës Kushtetuese të RSFJ-së**, të cilat shoqërohen me komentet e autorit në fjalë, vendime me të cilat anuloheshin një nga një si anti-kushtetuese vendimet e republikave dhe të **KSA të Kosovës** mbi shpalljen dhe vënien në jetë të pavarësisë së bashku me ligjet dhe aktet tjera implementuese të pavarësisë së shpallur nga to gjatë viteve 1990-1991).

Sikundër u tha më sipër, në fund të verës së vitit 1990, u suprimuan të gjitha organet e **KSAK-së,** proces që u kurorëzua me nxjerrjen e **Kushtetutës së Serbisë** (shtator 1990). Në këtë kohë, nga marsi 1989 deri në fund të verës së vitit 1990, **Serbia** në mënyrë graduale e vuri **Kosovën** në tërësi nën thundrën e sistemit të saj juridik-kushtetues, duke rrënuar të gjitha shenjat e identitetit kushtetues që vendi kishte gëzuar me vite sipas kushtetutave të vitit 1974 (të RSFJ-së dhe KSAK-së).[120] Kjo politikë prodhoi rezistencë masive në mesin e popullsisë shumicë në **Kosovë**, e cila deri në fillim të vitit 1998 pat qenë krejtësisht paqësore nën udhëheqjen e liderit të **Lidhjes Demokratike të Kosovës** (LDK) dhe presidentit të parë të **Kosovës**, **Dr. Ibrahim Rugova (1944-2006).** Gjatë kësaj kohe, kosovarët organizuan jetë paralele në sferën politike, sociale, arsimore, shëndetësore dhe ekonomike. Ky organizim paralel kishte për qëllim refuzimin e tërësishëm të integrimit të **Kosovës** në **Serbi**. **Kosova** dhe populli i saj shumicë **de facto** u përjashtuan nga çdo aspekt i jetës publike. Ata arritën, megjithatë, që t'i krijojnë vetes një lloj hapësire të jetës paralele publike, e cila jetë për serbët cilësohej si e huaj, por që me shumë sukses bashkekzistonte me hapësirën publike të imponuar me dhunë nga regjimi serb në **Kosovë**. Hapësira e imponuar serbe, për fat të keq, gjeti një përkrahje të madhe në mesin e popullsisë lokale serbe në **Kosovë**. Kjo situatë zgjati deri në fillim të vitit 1998, kur filloi një kryengritje e armatosur kundër regjimit të instaluar të Beogradit nën udhëheqjen e **UÇK-së**. Para se të flasim për paraqitjen e **UÇK-së** dhe shkaqet e saj, t'i kthehemi pak produktit më emblematik të kohë së jetës publike paralele në **Kosovë**, të organizuar nga **LDK-ja** e **Dr. Ibrahim Rugovës** dhe qeveria e tij në mërgim e udhëhequr nga **Dr. Bujar Bukoshi**. Fjalën e kemi për **Kushtetutën e Kaçanikut.**

Kushtetuta e Kaçanikut është miratuar nga përbërja e legjislaturës së fundit të **Kuvendit të KSAK-së**. Në këtë përbërje kanë marrë pjesë vetëm shqiptarët dhe disa prej deputetëve të komuniteteve joserbe dhe joshqiptare të **Kosovës**. Kuvendi ka vepruar në ilegalitet si pasojë e represionit serb dhe është mbledhur në **Kaçanik** të Kosovës për të miratuar këtë kushtetutë. Kjo ka ndodhur më datën 7 shtator 1990, në paralel me hapat e ngjashëm që i ndërmerrnin republikat ish-jugosllave dhe popujt e tyre në vijim të rezistimit të hegjemonisë serbe.

Teksti i Kushtetutës është bërë nga duart e juristëve dhe intelektualëve më të shquar të Kosovës së asaj kohe[121], siç ishte bërë edhe **Deklarata Kushtetuese** (2 korrik 1990) nga dora akademikut **Gazmend Zajmi** (1936-1995).[122] Për shkak të rrethanave të vështira, historikisht të papërsëritshme, teksti i Kushtetutës nuk i është nënshtruar diskutimit publik, përkatësisht si pasojë e rrethanave të vështira të represionit policor dhe ushtarak serb. Në aspektin formal, ajo është miratuar në vijim të respektimit të dispozitave të **Kushtetutës së KSAK-së** të vitit 1974. Ka pasur gjithsej njëqind e dyzetë (140) nene dhe është bazuar në parimin e ndarjes dhe baraspeshës së pushteteve, gjë që ka qenë risi për kohën, si dhe në garantimin e një katalogu të gjerë të lirive dhe të drejtave të njeriut.

---

120 Sipas **Kushtetutës së Serbisë** (shtator 1990), autonomia e Kosovës të cilën e gëzonte sipas Kushtetutës së RSFJ-së të vitit 1974, u suprimua dhe nuk ekzistonte më. Nenet 108-112 ["Krahina Autonome e Vojvodinës dhe Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë"] të Kushtetutës përcaktonin elementet bazë të"autonomisë së re " për Kosovën, kurse neni 6 ["Dispozitat Themelore "] emërtonte **Kosovën** si një krahinë autonome, krahas **Vojvodinës**, që gëzon një lloj autonomie lokale, pa asnjë premisë të autonomisë së dikurshme politiko- territoriale. **Kushtetuta e Zhabljakut** (sipas emrit të vendit në Mal të Zi, ku është draftuar) ka sanksionunar këtë pozitë të **Kosovës** dhe **Vojvodinës,** duke respektuar në tërësi dispozitat e **Kushtetutës së Serbisë** të vitit 1990. Në kapitullin II, kjo Kushtetutë ka pasur dispozitat mbi të drejtat e njeriut, kapitull që titullohej: "Liritë, të Drejtat dhe Detyrat e Individit dhe Qytetarit" (nenet 19 – 68).Edhe pse në paragrafin 4 të nenit 124, Kushtetuta fliste për ankesën individuale në rastet e cenimeve me aktet individuale të autoriteteve publike të të drejtave dhe lirive të individit të garantuara me Kushtetutë, ushtrimi praktik i ankesës individuale në territorin e Kosovës nuk kishte asnjë gjasë dhe mundësi. **Kosova** dhe populli i saj ishin futur në një geto kolektive në duart e regjimit represiv të diktatorit serb **S. Milosheviq**.

121 Grupi punues që ka punuar në draftin e Kushtetutës së Kaçanikut është përbërë nga: prof. dr. **Kurtesh Salihu**, prof. dr. **Ejup Statovci**, prof. dr. **Ismet Salihu**, prof. mr. **Fatmir Fehmiu** dhe **Halit Muharremi**. Cf. Skender Skenderi (ed.), *Si veproi Kuvendi i Republikës së Kosovës. Vëllimi I (4.12.1989 – 7.09.1990)* (Printing press: Prishtinë, 2016), fq. 401-402.

122 Ibid., fq 330-331.

T'i kthehemi tani çështjes ku ngelëm lidhur me paraqitjen e **UÇK-së** dhe rrethanat e kësaj paraqitjeje. Paraqitja e **UÇK-së** në skenën publike kosovare ka qenë rezultat imediat i ngritjes dramatike dhe të shpejtë të dhunës dhe represionit serb në Kosovë si dhe i dështimit të rrugës paqësore të presidentit **Dr. Ibrahim Rugova** dhe **LDK**-së. **Kosova** në këtë kohë qe përjashtuar nga çdo proces paqësor që kishte filluar në kontekstin e zgjidhjes së krizës dhe luftës në **ish-Jugosllavi**, siç janë rastet e përjashtimit nga dy konferencat e paqes të mbajtura në **Hagë** (1991-1992) dhe në **Londër** (1992-1995). Arritja e paqes në **Bosnje-Hercegovinë** paraqiti kulmin e pakënaqësisë së kosovarëve me rrugën paqësore: pas arritjes së **Marrëveshjes së Dejtonit** në nëntor të vitit 1995, me të cilën iu dha fund luftës dhe konflikteve në Bosnje-Hercegovinë, u duk sikur vetëm dhuna dhe lufta e armatosur po shpërblehej nga perëndimorët. Përjashtimi i **Kosovës**, me kërkesën shprehimore të diplomacisë amerikane, me sa duket shpërfaqi, në të njëjtën kohë, dy gjëra të rëndësishme:

- e para, ngritjen e represionit dhe dhunës në Kosovë për shkak se lideri serb, **S. Millosheviq**, pas **Marrëveshjes së Dejtonit** u pa si një njeri i paqes në **Ballkan** dhe si garantues i Dejtonit që besonte se perëndimi do ta toleronte pafundësisht pasi kishte marrë këtë rol të garantuesit të paqes; dhe,
- e dyta, ngritjen e frustrimit në mes të popullsisë shumicë në **Kosovë** për shpërblim të **Serbisë së Millosheviqit** në **Dejton**, përkundër luftërave të saj agresive dhe gjenocidale në territorin ish-jugosllav (**Bosnje-Hercegovinë** dhe **Kroaci**).[123]

Një vit pas arritjes së paqes në **Marrëveshjes së Dejtonit**, në verë të vitit 1996, në Kosovë nisën shenjat e para të shfaqjes së lëvizjeve ushtarake të shqiptarëve të **Kosovës**: në disa vende u sulmuan caqet ushtarake e policore serbe të instaluara në vend.[124] Vetëm një vit pas kësaj, megjithatë, u bë shumë e qartë se **Kosova** po shkonte drejt dhunës dhe konfliktit të armatosur me forcat policore e ushtarake serbe për shkak se represioni po merrte përmasa dramatike dhe të padurueshme. Në nëntor të vitit 1997, me daljen në skenë të **UÇK-së**, nisi ajo që të gjithë e kishin pritur: konfrontimi i hapur në mes të popullit shumicë të **Kosovës** dhe forcave policore e ushtarake serbe të instaluara në vend. Konflikti i hapur në mes të **UÇK-së** dhe forcave serbe, pas dy vitesh e detyroi bashkësinë ndërkombëtare për t'u vënë në lëvizje, gjatë verës së vitit 1997, për t'u intensifikuar në fund të atij viti.

Bashkësia ndërkombëtare, në veçanti amerikanët, e kishin duruar Serbinë deri në fillim të vitit 1999. Pas masakrës së **Reçakut** në janar të vitit 1999, u bë fare e qartë se **Serbia e Millosheviqit** po synonte qëllimin e njëjtë si në **Bosnje-Hercegovinë** dhe **Kroaci**, përkatësisht përfitime territoriale me dhunë dhe përmes spastrimit etnik të kulturave e popujve joserbë. Për të ndaluar një gjë të tillë, bashkësia ndërkombëtare, nën udhëheqjen e vendeve perëndimore dhe **Rusisë**, i a.q. **Grupi i Kontaktit**, thirri një konferencë ndërkombëtare për paqen në Kosovë, e cila u mbajt në **Rambuje** të **Francës**.[125] Kjo konferencë kishte për qëllim gjetjen e një zgjidhje paqësore rreth mospajtimeve serioze në mes të serbëve e shqiptarëve. Mospajtimet po rrezikonin paqen dhe sigurinë në rajon dhe më gjerë. **Konferenca e Rambujesë** ka mbaruar më datën 23 shkurt të vitit 1999 dhe ka prodhuar një dokument jashtëzakonisht të detajuar, që ka qenë rezultat i javëve të tëra të negocimit intesiv në mes të palëve në konflikt, atë që njihet si **Marrëveshja e Rambujesë**.

---

123 Cf. Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar. Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi* (KOHA: Prishtinë, 2009) fq. 129-142; Marc Weller, "The Rambouillet Conference on Kosovo" *International Affairs* Volume 75, Issue 2 (April 1999) fq. 211-251 në fq. 218; Dimitar Bechev, *Rival Power: Russia's Influence in Southeast Europe*, fq.41-42; P. M. H. Bell & Mark Gilbert, *The World Since 1945: An International History*, fq. 468-471.

124 Noel Malcolm, *Kosovo. A Short History*, fq. 355.

125 Marc Weller, "The Rambouillet Conference on Kosovo", fq.227-238; Dimitar Bechev, *Rival Power: Russia's Influence in Southeast Europe*, fq.40-48.

Nuk ishin vetëm negociatorët në **Rambuje** ata që kontribuuan në formësimin përfundimtar të tekstit të saj: shumë kohë para se ajo të përpilohej, **Komisioni i Venecias** e pati marrë përsipër kryerjen e një vlerësimi të brendshëm dhe tërësisht konfidencial lidhur me pozitën kushtetuese të Kosovës dhe popullsisë së saj shumicë nën regjimin millosheviqian. Si pikë referimi për këtë vlerësim kishin qenë **Kushtetuta e Serbisë (**1990) dhe **Kushtetuta e Zhablakut (**1992), mirëpo vetëm aq sa ka qenë e domosdoshme për raportim dhe vlerësim të pozitës së Kosovës dhe popullsisë së saj shumicë në **RFJ**.[126] Ndërkaq, raporti që u prodhua, bënte vlerësime që kishin për qëllim për të shërbyer si një udhëzues për draftim, në kohën që po vinte, të një marrëveshjeje të paqes në mes të shqiptarëve të Kosovës dhe qeverisë së **Beogradit** si forcë sunduese.

Komisioni në këtë raport nuk pat lënë asnjë dyshim lidhur me pozitën e vështirë të popullsisë shumicë, statusin e saj inferior në pikëpamje kushtetuese dhe gjendjen e keqe të lirive dhe të drejtave njerëzore për shkak të diskriminimit serb intensiv. Me qëllim të daljes nga kjo gjendje e rëndë, ai raport vlerësonte se duhej propozuar vënia në jetë e standardeve të duhura ndërkombëtare lidhur me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive njerëzore, duke ndjekur rrugën e mishërimit të këtyre standardeve në tekstet kushtetuese të Kosovës në kohën që po vinte. Kjo qasje e Komisionit, në veçanti u vu në spikamë në pjesën e diskutimit lidhur me çështjen e vetëqeverisjes lokale, e cila u pa si një instrument kornizë që do të shërbente për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Kjo qasje, pak a shumë, u shndërrua në një udhëzues për draftuesit e **Marrëveshjes së Rambujesë**, si dhe i të gjitha teksteve të mëspatajme kushtetuese në **Kosovë** në kohën që po vinte, përfshirë këtu Kushtetutën e vitit 2008.

Marrëveshja e Rambujesë, siç do të shihet në vijim, ka përmbajtur dispozita kushtetuese që ishin të modeluara sipas vijave kryesore të skicuara në raportin e vlerësimit të Komisionit. Kjo është e qartë në veçanti kur flitet për dispozitat që rregullojnë organizimin e pushtetit dhe marrëdhëniet e pushtetit brenda territorit të Kosovës,[127] si dhe dispozitat lidhur me vendin dhe rolin e të drejtave dhe lirive njerëzore dhe të minoriteteve.[128] Thënë ndryshe, dispozitat e **Marrëveshjes së Rambujesë** parashikonin me saktësi të njëjtat standarde për vetëqeverisje lokale, mbrojtjen dhe promvimin e lirive dhe të drejtave të njeriut e të minoriteteve me ato që ishin parashikuar në raportin e vlerësimit të Komisionit. Kjo dilte nga fakti se vlerësimi i tij ishte bërë në gusht të vitit 1998, disa muaj para se të ndodhte **Konferenca e Rambujesë.**

Marrëveshja e Rambujesë, përkundër faktit që ka pasur një natyrë të përkohshme, përfaqëson një dokument shumë të elaboruar që kishte për qëllim parësor ndalimin e dhunës dhe të luftës në Kosovë si dhe krijimin e kushteve për themelimin e një autonomie substanciale në Kosovë. Si i tillë, ky dokument ka pasur karakter të dyfishit: prospektiv dhe retrospektiv. Ngjashëm me **Marrëveshjen e Dejtonit për Bosnje-Hercegovinën** (nëntor, 1995), **Marrëveshja e Rambujesë** ka ngërthyer një rrjet mjaft të detajuar të dispozitave me të cilat mëtohej rregullimi i të gjitha aspekteve të jetës në Kosovë pas mbarimit të luftës, por edhe dispozita tjera që synonin nxitjen e ndryshimeve të menjëhershme në terren (ndalimi i dhunës dhe i luftës së armatosur në mes të palëve).

---

126 European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Draft outline of main elements for an agreement on Kosovo*. **CONFIDENTIAL** (Council of Europe: Strasbourg, 31/08/98).

127 **Marrëveshja e Rambujesë**: Kuadri, neni I ["Parimet"], nën 4. Më pastaj, në **Kushtetutën e Rambujesë** në mënyrë të detajuar janë përcaktuar rregullat mbi organizimin e pushtetit në nivel të Kosovës si dhe marrëdhëniet e këtij pushteti me **RFJ** dhe me **Republikën e Serbisë.**

128 **Marrëveshja e Rambujesë**: Kuadri, neni I ["Parimet"], nën 5. Më pastaj, në **Kushtetutën e Rambujesë** në mënyrë të detajuar janë përcaktuar rregullat mbi marrëdhëniet e pushtetit politik me individin, liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të komuniteteve, me fokus të veçantë respektimi i parimit të mosdiskriminimit dhe zbatimi i standardeve më të larta ndërkombëtare mbi liritë dhe të drejtat e njeriut.

Ky dokument, megjithatë, nuk u jetësua asnjëherë si pasojë e refuzimit të tij nga ana e diktatorit serb **S. Milosheviq**, i cili vazhdoi me politikat e veprimit violent dhe represiv kundër popullsisë shumicë në Kosovë. Meqë shqiptarët nënshkruan dokumentin e Konferencës, kurse Serbia intensifikoi represionin dhe dhunën në **Kosovë**, kaq mjaftonte që të hapeshin dyert për sulme ushtarake të **NATO**-s kundër caqeve policore dhe ushtarake të **RFJ-së** me qëllim të ndërprerjes së mizorive që regjimi po bënte kundër popullsisë shqiptare, dhunës e terrorit që kishte marrë përmasa gjenocidale.[129]

Fushata ajrore e **NATO**-s mbaroi pas 78 ditëve të sulmeve intensive kundër caqeve në tërë territorin e **RFJ-së**, dhe u pasua me futjen e trupave të **NATO**-s në Kosovë dhe themelimin e një administrate ndërkombëtare të përkohshme nën lidershipin e OKB-së, e njohur si administrata ndërkombëtare e **UNMIK-ut**, bazuar në **Rezolutën 1244**. Edhe pse nuk u jetësua asnjëherë si pasojë e dështimit serb për ta nënshkruar, ndërhyrjes ushtarake të NATO-s kundër RFJ-së dhe instalimit të administratës së UNMIK-ut në bazë të Rezolutës 1244 **Marrëveshja e Rambujesë** ka një rëndësi të madhe historike e praktike si tekst juridiko-kushtetues për shkak se ka pasur karakter ndërkombëtar, gjë që nuk ka qenë rasti me **Kushtetutën e Kaçanikut**. Kjo rëndësi shihet në dy aspekte:

- e para, sepse për herë të parë pas vitit 1974, **Kosovës** i njihet një identitet i qartë kushtetues në të gjitha aspektet e tij; dhe
- e dyta, sepse **Kosova** për herë të parë fiton një gjykatë kushtetuese të proveniencës perëndimore liberale të modeluar sipas sistemit **evropian/kelsenian**.

Nuk ka rëndësi që kurrë nuk u zbatua në Kosovë. E rëndësishme është që dokumenti paraqet pjesë përbërëse të historisë kushtetuese të Kosovës. Shumë dispozita të saj, sikundër do të shihet, janë reflektuar dhe transportuar në të gjitha dokumentet kushtetuese të Kosovës pas çlirimit nga serbët (10 qershor 1999). Të tilla janë, ta zëmë, **Korniza Kushtetuese**[130] dhe Kushtetuta e vitit 2008. Këto aspekte kanë rëndësi dhe duhet të diskutohen në vijim, për arsyet si vijon:

- e para, sepse prekin identitetin kushtetues të Kosovës së sotme;
- e dyta, sepse kanë të bëjnë me vënien në jetë në Kosovë të standardeve ndërkombëtare dhe evropiane për promovimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut; dhe
- e treta, sepse kanë të bëjnë me vetë llojin e gjyqësisë së re kushtetuese që mëtohej të instalohej në Kosovë pas vënies në jetë të **Marrëveshjes së Rambujesë**, diçka që ka ndodhur vetëm pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Se **Marrëveshja e Rambujesë** po mëtonte ndërtimin nga hiçi të një identiteti të ri kushtetues të Kosovës, kjo vërehet nga dispozitat e saj kryesore dhe anekseve përbërëse. Që në preambulë flitej për synimin parësor të hartuesve: zgjidhjen paqësore dhe me mjete politike të statusit përfundimtar të Kosovës. Për të arritur këtë Marrëveshja përbëhet nga dy pjesë: **pjesa kuadër** dhe **pjesa e shtojcave** që paraqet pjesë të saj. Pjesa kuadër ka dy nene.

---

129 Për rezistencën paqësore të popullit shumicë në Kosovë nga viti 1989 deri në fillim të vitit 1998, për luftën e viteve 1997-1998, për negociatat në **Rambuje**, përfshirë përpilimin e **Marrëveshjes së Rambujesë** (shkurt 1999), nënshkrimin e saj nga shqiptarët dhe refuzimin nga ana e serbëve, cf. më shumë në Marc Weller "Rambouillet Conference on Kosovo", fq. 211-251; Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar. Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi* (KOHA: Prishtinë, 2009) fq. 189-254.

130 **Korniza Kushtetuese** ka hyrë në fuqi më 15 maj 2001, si **Rregullore e UNMIK-ut Nr. 2001/9**, dhe është shpallur nga ana e PSSP-së të OKB-së. Si e tillë, ka pasur cilësinë e një legjislacioni të autorizuar dhe të nxjerrë nga ana e UNMIK-ut konform **Rezolutës 1244** të KS të OKB-së dhe **Rregullores Nr. 01** të datës 15 korrik 1999. Ky dokument, i nxjerrë me synimin për të krijuar bazën e rendit kushtetues kosovar, ka pasur rangun dhe vlerën e njëjtë si rregulloret dhe aktet tjera të **UNMIK**-ut të nxjerra pas qershorit 1999 deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008.

Neni I ["Parimet Themelore"] fokusohet kryesisht në liritë dhe të drejtat e njeriut, duke parashikuar liri dhe të drejta shtesë për anëtarët e bashkësive nacionale. Ajo çfarë bie në sy është së në këtë periudhë kalimtare, Marrëveshja kishte parashikuar të drejtën e qytetarëve të Kosovës për t'i adresuar ankesat e tyre lidhur me liritë dhe të drejtat e njeriut pranë organeve dhe institucioneve relevante ndërkombëtare. Përveç kësaj, mosdiskriminimi dhe barazia e të gjithëve përcaktohej si një ndër shtyllat kryesore të sistemit vetëqeverisës në **Kosovë**, kurse zgjedhjet e lira dhe të ndershme duhej të ishin mënyra e vetme e formimit të vullnetit kolektiv në vend.

Liritë dhe të drejtat e njeriut dhe formimi i këtij vullneti politik, pa asnjë diskriminim, duhej të realizohej pa ndërhyrjen e autoriteteve të **RFJ-së** dhe të **Republikës së Serbisë**. Kjo ishte kështu për shkak se, sipas parimeve themelore dhe vetë tekstit të **Marrëveshjes së Rambujesë**, zgjidhja e përkohshme nuk prekte sovranitetin federal mbi Kosovën: integriteti dhe sovraniteti territorial i **RFJ-së** ngelej i paprekur dhe i garantuar. Kjo dispozitë, megjithatë, vlente vetëm deri në zgjidhjen e statusit final të Kosovës.

Kushtetuta e Kosovës, si shtojcë e parë e **Marrëveshjes së Rambujesë**, shërbente si një pikë referimi për realizimin e lirive dhe të drejtave njerëzore dhe për mënyrën e ushtrimit të pushtetit. Në rast të konfliktit (mospajtimit) në mes tyre, Marrëveshja kishte epërsi. Kjo është e kuptueshme nëse kihet parasysh fakti se, njëjtë si në rastin e **Marrëveshjes së Dejtonit**, ky dokument përbënte shtojcë të saj, e cila ishte e vetmja që posedonte cilësinë e dokumentit me garancione ndërkombëtare.

Neni II ["Masat e Ndërtimit të Besimit"] ka folur për ndalimin e përdorimit të forcës, duke shërbyer si një kuadër për zgjidhjen e çështjeve që kishin të bënin me konfliktin e armatosur në Kosovë. Ndër këto çështje kanë qenë: refugjatët dhe personat e zhvendosur, kthimi i tyre nëpër vatrat e tyre, personat e zhdukur dhe të kidnapuar, amnistia e atyre që kanë marrë pjesë në konfliktin e armatosur në Kosovë, ndihma ndërkombëtare për rindërtimin e vendit dhe, në fund, themelimi i mediave të lira dhe të pavarura kosovare. Sikundër u tha më sipër, pjesa kuadër e Marrëveshjes operacionalizohej përmes shtojcave, të cilat kanë qenë pjesë e pandashme e saj.[131]

[131] Autori i parë i këtij libri ka shërbyer si këshilltar ligjor i **Delegacionit të Kosovës në Konferencën e Rambujesë,** e cila u mbajt në qytetin e **Rambujesë** afër **Parisit** nga data 6 shkurt deri më 23 shkurt 1999. Në aspektin formal, ndërkaq, **Marrëveshja e Rambujesë** është nënshkruar në Paris më datën 18 mars 1999 për shkak se asnjëra palë nuk qe e gatshme për nënshkrim ditën e mbylljes së Konferencës. Në fakt, konferenca qe parashikuar të mbyllet në mesditë të datës 20 shkurt 1999, por që shtyrë për tri ditë nënshkrimi i saj. Kur u pa që as atë ditë nuk mund të bëhej nënshkrimi i saj, organizatorët e Konferencës, **Grupi i Kontaktit** (i përbërë nga SHBA-të, Britania e Madhe, Rusia, Franca, Gjermania dhe Italia) e shtynë të njëjtën për datën 15 mars 1999. Autori i parë i ka të freskëta kujtimet rreth punës aty, kur secila shtojcë e draft-**Marrëveshjes për Paqe** është diskutuar me secilin delegacion veç e veç gjatë një dite së paku, për t'u përcjellë ditën në vijim te pala tjetër, kurse në fund të punimeve të Konferencës, ndërmjetësuesit ndërkombëtar e kanë prezantuar para secilës palë veç e veç për miratim tekstin përfundimtar. Në fund të bisedimeve paqësore në **Rambuje,** më datën 19 shkurt 1999, ishte planifikuar të bëhej nënshkrimi përfundimtar i marrëveshjes. Me atë rast, serbët nuk pranuan të nënshkruanin tekstin e draft-marrëveshjes, kurse pala kosovare kërkoj një afat shtesë për nënshkrimin e saj, një raund të dytë të bisedimeve. Ky afat u shty për një muaj.Në raundin e dytë të bisedimeve, të mbajtura në Paris nga data 15 deri 18 mars 1999, shqiptarët nënshkruan tekstin e **Marrëveshjes së Rambujesë**, të ofruar nga ndërmjetësuesit ndërkombëtarë, më datën 18 mars 1999. Serbët ngulën këmbë për mos nënshkrim të saj ani se kishin marrë pjesë aktive në bisedimet e paqes. Kjo rrethanë shërbeu si shkas imediat për nisjen e sulmeve të **NATO**-s kundër caqeve serbe (24 mars – 10 qershor 1999). Kjo pati për pasojë kapitullimin e Serbisë dhe hyrjen e trupave të **NATO**-s dhe të **UÇK-së** në Kosovë më datën 10 qershor 1999. Kjo nuk nënkuptonte, megjithatë, se **Marrëveshja e Rambujesë** kishte vdekur: **Rezoluta 1244** e mori atë për bazë për ndërtimin e sistemit të ri të vetëqeverisjes në **Kosovë** deri në arritjen e një marrëveshjeje politike në mes të palëve lidhur me statusin përfundimtar të **Kosovës.** Për këtë flasim sërish më vonë. Për një studim analitik dhe me kompetencë në aspektin juridiko-ndërkombëtare, origjinal deri në fund, të **Konferencës së Rambujesë**, cf. punimin e njërit prej këshilltarëve ndërkombëtarë të e **Delegacionit të Kosovës**, Marc Weller, "The Rambouillet Conference on Kosovo", fq. 211–251 (ku autori diskuton aspektet juridiko-ndërkombëtare dhe juridiko kushtetuese të Konferencës, duke u fokusuar në veçanti në ndryshimet fundamentale në rolin e akterëve ndërkombëtar në krizën e Kosovës, në luftën në mes të vlerave themelore të rendit ndërkombëtar dhe zgjidhjes

Si shtojcë e parë, siç u tha më sipër, na paraqitet **Kushtetuta e Kosovës**, përkatësisht **Kushtetuta e Rambujesë**, e cila ka pasur preambulën dhe vetëm 11 nene. Njëjtë si në rastin e **Kushtetutës së Bosnje-Hercegovinës**, e cila është pjesë e **Marrëveshjes së Dejtonit**, kjo kushtetutë ka qenë e paramenduar të jetë pjesë e një marrëveshjeje ndërkombëtare, **Marrëveshjes së Rambujesë**. Një gjë e tillë nënkupton se normat e kësaj të fundit (Marrëveshjes) do të duhej të kishin epërsi (superioritet) ndaj stipulimeve të Kushtetutës. Kjo bëhet e qartë qysh në nenin e parë të saj, që bënte fjalë për parimet e vetëqeverisjes në Kosovë. Aty thuhej se vetëqeverisja ushtrohej në pajtim me kushtet e përcaktuara në Marrëveshje, përmes organeve legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore, si dhe përmes organeve e institucioneve të tjera të përcaktuara aty.

Pjesët tjera të këtij neni kanë bërë fjalë për të drejtat e njeriut dhe të komuniteteve nacionale në Kosovë, marrëdhëniet e kësaj të fundit me **RFJ-në** dhe **Serbinë**, në veçanti në sferën e politikës së jashtme dhe çështjeve që kanë të bëjnë me sovranitetin dhe integritetin territorial të **RFJ**-së, pandryshueshmërinë e kufijve të **Kosovës**, si dhe çështje të tjera lidhur me to.

Neni i dytë bënte fjalë për organin legjislativ-**Kuvendin e Kosovës.** Ky organ parashikohej t'i kishte 120 (njëqind e njëzet) anëtarë, nga të cilët 80 (tetëdhjetë) do të zgjidheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë, kurse 40 (dyzetë) të tjerët do të ndaheshin në mes të bashkësive nacionale. Neni i tretë dhe i katërt bënte fjalë për kryetarin, qeverinë dhe administratën e **Kosovës**, kurse neni i pestë në pjesën e tij të përgjithshme e kishte futur **Gjykatën Kushtetuese të Kosovës** në kuadër të pushtetit gjyqësor kosovar. Në hierarkinë gjyqësore, megjithatë, nuk ka bërë pjesë Gjykata Kushtetuese. Kjo shihej në faktin se ekzistonin vetëm tri nivele të gjyqësorit kosovar: **Gjykata Supreme e Kosovës**, gjykatat e qarkut dhe gjykatat komunale.

Përbërja dhe juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese përcaktohej me pikat 5-8 të nenit të pestë. Ajo duhej të kishte nëntë gjyqtarë, ku secila nga bashkësitë nacionale të Kosovës do ta kishte nga një, kurse pesë gjyqtarët tjerë qe përcaktuar se do të duhej të përzgjidheshin nga kryetari i **GJEDNJ-së**.

Nenet tjera të **Kushtetutës së Rambujesë** flisnin për çështjet lidhur me funksionimin e komunave (neni tetë); përfaqësimin e Kosovës në **RFJ** dhe në **Republikën e Serbisë** (neni nëntë); formën dhe përmbajtjen e amendamentimit (neni dhjetë); dhe, në fund fare, hyrjen e saj në fuqi (neni i njëmbëdhjetë).

Kapitujt tjerë, si shtojca të **Marrëveshjes së Rambujesë**, të cilët nuk i diskutojmë në mënyrë të detajuar në këtë libër, kanë pasur të bëjnë me sa vijon:

- kapitulli 2 ["Sigurimi publik policor dhe civil"];
- kapitulli 3 ["Zhvillimi dhe mbikëqyrja e zgjedhjeve"];
- kapitulli 4 ["Çështjet ekonomike"];
- kapitulli 5 ["Implementimi I"];
- kapitulli 6 ["Ombudsmani"];
- kapitulli 7 ["Implementimi II"]; dhe, së fundi,
- kapitulli 8 ["Amendamentimi, vlerësimet gjithëpërfshirëse dhe dispozitat përfundimtare"]

Në pikën e tretë të nenit të parë të kapitullit të tetë dhe të fundit të **Marrëveshjes së Rambujesë** gjendet dispozita famoze që për herë të parë i njihte Kosovës ndërkombëtarisht të drejtën e vendosjes për fatin e saj politik (**të drejtën për referendum**). Në këtë pikë thuhej se pas tri vjetësh do të ndërtohej një mekanizëm për zgjidhjen përfundimtare të statusit të Kosovës në një tubim të serishëm ndërkombëtar. Ky mekanizëm

së statusit të Kosovës dhe, në fund, në legjitimitetin e kërcënimit me forcë dhe përdorimit të forcës në kontekstin e ndërprerjes së dhunës dhe krizës humanitare në Kosovë); Për diskutimin në detaje të draftit sipas shtojcave dhe sjelljen fillestare të **Delegacionit Kosovar**, cf. ibid. fq. 227-232; Për bojkotin e **Delegacionit serb** dhe sjelljen e tyre të pahijshme gjatë **Konferencës së Rambujesë** si dhe dërgimin e forcave të mëdha ushtarake e policore në **Kosovë** gjatë bisedimeve të **Rambujesë** dhe **Parisit** me qëllim të shkatërrimit të rezistencës dhe dëbimit masiv të kosovarëve, cf. Ibid. fq. 228-229 & 234-236.

përcaktohej se do të kishte për detyrë të merrte këto kritere parasysh me rastin e vendosjes për statusin përfundimtar të Kosovës:

- vullnetin e popullit;
- mendimin e autoriteteve relevante ndërkombëtare;
- kontributin e palëve në impelementimin e **Marrëveshjes së Rambujesë**; dhe, së fundi,
- **Aktin Final të Helsinkit**.

Mbi bazën e këtyre kritereve, në këtë nen thuhej se bashkësia ndërkombëtare, pas tri vjetësh do të bënte një vlerësim të tërësishëm të implementimit të **Marrëveshjes së Rambujesë**, duke marrë parasysh propozimet e palëve për çdo masë tjetër shtesë. Kjo, megjithatë, nuk u bë asnjëherë sepse serbët nuk e nënshkruan **Marrëveshjen e Paqes** dhe pasoi bombardimi i **NATO**-s për të ndaluar makinerinë agresive dhe brutale ushtarako- policore dhe paramilitare të diktatorit **S. Millosheviq** për të kryer edhe një gjenocid të ri në **Kosovë** kundër popullsisë së saj shumicë. Vetëm disa vite më vonë do të vihej në lëvizje ideja e një mekanizmi për zgjidhjen e statusit të Kosovës, siç ishte parashikuar në **Rambuje**: vënia në jetë e kësaj ideje nisi me një vlerësim të gjithanshëm të bërë nga ndërmjetësuesi ndërkombëtar, diplomati norvegjez **Kai Aide**, në raportin e tij të vitit 2004 të cilin e kishte përpiluar sipas mandatit të dhënë nga Sekretari i Përgjithshëm i **OKB**-së. Mbi bazën e këtij raporti nisën bisedimet ndërkombëtarisht të autorizuara dhe ndërmjetësuara për zgjidhjen e statusit politik të **Kosovës**. Për këtë dhe çështjet lidhur me këto flasim në vijim të këtij libri.

T'i kthehemi tani çështjes së **lirive dhe të drejtave të njeriut** të përmbajtura në të gjitha dokumentet kushtetuese të Kosovës, të nxjerra pas mbarimit të **Luftës së Ftohtë**. Nga dokumentet kushtetuese të diskutuara si më sipër që kanë të bëjnë me kohën pas **Luftës së Ftohtë**, qofshin ato të miratuara nga vetë kosovarët apo me ndërmjetësimin ndërkombëtar, sanksionohen aspekte të rëndësishme kushtetuese të Kosovës që janë me rëndësi për historinë kushtetuese të **Kosovës**, siç janë: synimi për një rregullim shtetëror të **Kosovës** si një demokraci parlamentare kushtetuese, ndarja dhe balancimi i pushteteve, pavarësia e gjyqësorit dhe e organeve të drejtësisë, ekzistimi i agjencive të pavarura për të ushtruar disa nga funksionet administrative të shtetit kosovar dhe kështu me radhë.

Ndër aspektet më të rëndësishme që sanksionoheshin në secilin prej dokumenteve si më sipër është ai që ka të bëjë me **liritë dhe të drejtat e njeriut**. Ky aspekt përbën ndër shtyllat kryesore të **identitetit kushtetues** të **Kosovës** së re, të pavarur dhe sovrane, i cili ka nisur të ndërtohet në mënyrë graduale që nga mbarimi i **Luftës së Ftoftë**, duke filluar me **Kushtetutën e Kaçanikut** e deri te Kushtetuta e vitit 2008. Të shohim si janë reflektuar këto në tekstin e **Marrëveshjes së Rambujesë**, meqenëse për liritë dhe të drejtat e njeriut në **Kushtetutën e Kaçanikut** folëm më sipër.

Të drejtat dhe liritë themelore sipas përcaktimit të nenit gjashtë ["Të Drejtat dhe Liritë e Njeriut"] dhe shtatë ["Bashkësitë Nacionale"] të **Kushtetutës së Rambujesë** paraqesin modelin pararendës, që më vonë do të ndiqet nga **Korniza Kushtetuese** (2001) dhe **Kushtetuta e Kosovës** (2008). Në sferën e **lirive dhe të drejtave të njeriut** dhe të asaj që tani quhen **komunitetet e Kosovës**, me këtë kushtetutë, në fakt, nis faza e parë të ndërtimit të identitetit të ri efektiv kushtetues të Kosovës, identitet që aspak nuk përputhet me kulturën materiale të shoqërisë kosovare në të gjitha fazat e zhvillimit të saj në të kaluarën. I vetmi dallim është në terminologji, sepse konceptualisht asnjë dallim substancial nuk ekziston: në ndërkohë që në **Kushtetutën e Rambujesë** është përdorur fjala "bashkësi nacionale", në Kushtetutën e vitit 2008 flitet për "komunitetet" dhe përfshinë jo vetëm komunitetet nacionale por edhe ato etnike, gjuhësore, fetare dhe komunitetet tjera.

Kushtetuta e Rambujesë nuk ka qenë aq e gjerë në sferën e **lirive dhe të drejtave e lirive fundamentale.** Nenet gjashtë dhe shtatë nuk kanë parashikuar një listë të dokumenteve ndërkombëtare që do të zbatoheshin në **Kosovë** pas mbarimit të luftës dhe konfliktit të armatosur. I vetmi përjashtim në këtë aspekt ka qenë **KEDNJ-ja** dhe protokollet e saj, të cilat, sipas pikës së dytë të nenit gjashtë, do të zbatoheshin drejt-

përsëdrejti në **Kosovë**. Përveç këtij instrumenti ndërkombëtar, **Marrëveshja e Rambujesë** në pikën e parë të nenit të njëjtë, lidhur me liritë dhe të drejtat themelore përdor një formulim i cili pas luftës do të përsëritet në dokumentet relevante kushtetuese. Ai formulim është si vijon:
"[...] Të gjitha autoritetet publike në Kosovë do të përkujdesen për vënien në jetë të drejtat e liritë njerëzore, të cilat ndërkombëtarisht janë të pranuara".
Të **drejtat dhe liritë** e stipuluara në këtë mënyrë parashihej të kishin supremaci (epërsi) ndaj çdo ligji tjetër që mund të ishte i zbatueshëm në territorin e Kosovës.

Të drejtat e bashkësive nacionale, në anën tjetër, sipas nenit shtatë, pika e parë, të **Kushtetutës së Rambujesë** kanë qenë të konceptuar si të drejta dhe liri shtesë me qëllim që atyre t'iu mundësohej ruajtja dhe kultivimi i identitetit nacional, kulturor, fetar dhe gjuhësor në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe **Aktin Final të Helsinkit**. Kjo qasje e largimit radikal nga e kaluara nuk ka pasur për qëllim ruajtjen e traditave dhe zakoneve ekzistuese nga e kaluara e as ruajtjen e aspekteve tjera të strukturës kulturore materiale të shoqërisë kosovare, të cilat kishin qenë pjesë përbërëse e historisë së kaluar dhe mjaft tragjike të **Kosovës**. Qasja, përkundrazi, ka qenë një hap i vetëdijshëm dhe i kryer me ndërgjegje me qëllim të largimit të **Kosovës** nga e kaluara e saj tragjike dhe trashëgimia e hidhur socio-kulturore, politike dhe tjetër. Se kjo është kështu u pa pas luftës së Kosovës, kur më konkretisht u sqaruan burimet kosovare për të liritë dhe të drejtat e njeriut, ashtu siç kishte vepruar **Afrika e Jugut** kur kishte refuzuar regjimin e **Apartheid**-it dhe përqafimin në të njëjtën kohë të vlerave, parimeve, normave dhe zakoneve bazë të shoqërive liberale perëndimore.[132]

Kjo **shkëputje me të kaluarën**, një **shkëputje krejt radikale**, pra, u ndoq me qartë pas luftës dhe u reflektua në të gjitha tekstet kushtetuese të Kosovës. Këtë do ta shohim në rreshtat në vijim të këtij seksioni. Me këtë qasje, **Kosova** pas luftës i dha përparësi absolute të drejtës ndërkombëtare mbi liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, duke e bërë këtë të drejtë një normë kushtetuese vendore. Kjo është kështu sepse **Kushtetuta e Rambujesë** sikur e la disi të paqartë çështjen e burimeve të së drejtës në lëmin e të drejtave dhe lirive fundamentale të individit. Aty fare nuk përmenden se cilat instrumente regjionale dhe universale janë të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë në **Kosovë** si norma me karakter superior kushtetues.

Për herë të parë në mënyrë shprehimore, prioriteti i të drejtës ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut u trajtua në **Kornizën Kushtetuese**, një derivat i autoritetit të KS të OKB-së sipas **Rezolutës 1244**. Për dallim nga **Kushtetuta e Rambujesë,** që kishte njohur supremacinë (epërsinë) e standardeve të njohura ndërkombëtarisht mbi të drejtat e njeriut ndaj çdo ligji vendor, **Korniza Kushtetuese** specifikonte një nga një tekstet ndërkombëtare, të cilat do të kishin një supremaci (epërsi) ndaj legjislacionit vendor në lëmin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Me fjalë të tjera, në ndërkohë që **Kushtetuta e Rambujesë** përdorte vetëm shprehje abstrakte sipas të cilave autoritetet publike në Kosovë detyroheshin të sigurojnë supre-

[132] Për dallimin në mes të **kushtetutave transformative** dhe **jo transformative**, shih më shumë në: Cass R. Sunsstein, *Designing Democracy: What Constitutions Do* (Oxford University Press: Oxford, 2001) fq. 67-68; Juan E. Mendez, "Constitutionalism and Transitional Justice". Në Michel Rosenfeld and Andras Sajo (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law* (Oxford University Press: Oxford, 2012) fq. 1270-1286 në fq. 1282-1285. Duhet të theksohet se, megjithatë, **Cass R. Sunstein** i konsideron si ruajtëse të traditave të kaluara të gjitha kushtetutat e vendeve ish-komuniste të **Evropës**. Kjo sepse, siç e thotë ai vetë, "ato provojnë të ndërtohen mbi botëkuptimet që paradatojnë komunizmin". Cf. Ibid., fq. 68.
Ky botëkuptim është gabim, natyrisht: dallimi në mes të dy llojeve bazohet në atë nëse kushtetutat synojnë të ruajnë traditat e mëparshme individuale, pra jo traditat e kulturave dhe civilizimeve të tjera. Sikur të ishte kështu, atëherë çdo kushtetutë e vendeve të botës së tretë dhe kushtetutat e vendeve tjera të modeluara sipas standardeve perëndimore mbi demokracinë kushtetuese pas rënies së sistemeve të tyre totalitare do të konsideroheshin si kushtetuta që ruajnë (konservojnë) të kaluarën. Këto vende, si p.sh. **Spanja**, **Portugalia**, **Greqia** etj., apo të tjerat si **Kili**, **Nikaragua, Hondurasi**, **Angola**, **Mozambiku** etj., do të cilësoheshin si kushtetuta ruajtëse (konservuese) të traditave të kaluara, përkundër faktit se tërë përpjekjet e tyre kanë qenë që të shkëputen nga e kaluara e tyre totalitare.

mainë (epërsinë) e standardeve të njohura ndërkombëtarisht mbi të drejtat dhe liritë njerëzore, **Korniza Kushtetuese** specifikonte një nga një instrumentet ndërkombëtare që duheshin vënë në jetë nga secili autoritet publik kosovar me rastin e trajtimit të rasteve të lirive dhe të drejtave njerëzore. Kjo përfshinte jo vetëm të drejtat e liritë individuale por edhe ato që u përkisnin komuniteteve kosovare. Një zgjidhje si kjo, pra, specifikimi i instrumenteve ndërkombëtare të cilat do të zbatoheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë në **Kosovë** nga secili autoritet publik me rastin e adresimit të çështjeve të lirive dhe të drejtave njerëzore, individuale dhe kolektive, është përqafuar nga Kushtetuta e vitit 2008. Kjo vërehet nëse krahasohen dispozitat mbi liritë dhe të drejtat njerëzore të **Kornizës Kushtetuese** me dispozitat e kapitujve II ["Të Drejtat dhe Liritë Themelore'] dhe III ["Të Drejtat e Komuniteteve dhe Anëtarëve të Tyre"] të Kushtetutës së vitit 2008. Në të njëjtën kohë, me Kornizë për herë të parë parashikohet zbatimi i drejtpërdrejtë[133]dhe i tërthortë[134] i marrëveshjeve ndërkombëtare mbi liritë dhe të drejtat e njeriut në tërë territorin e Kosovës. Kjo ngjashmëri me Kushtetutën e vitit 2008 daton që nga zgjidhjet e dhëna në nenet e sipër cekura, gjashtë dhe shtatë, të **Kushtetutës së Rambujesë**.[135] Kjo nënkupton, me fjalë të tjera, se **Kushtetuta e Rambujesë** ka nisur internacionalizimin përmes kushtetutës të normave ndërkombëtare mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, mirëpo pa i specifikuar instrumentet konkrete që do të shërbenin si burime të së drejtës kushtetuese kosovare në lëmin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Këtë e bëri **Korniza Kushtetuese**, duke ngërthyer dispozita që internacionalizonin instrumentet e caktuara regjionale dhe universale mbi të drejtat e liritë fundamentale të individit me qëllim që të njëjtat të shërbenin si e drejtë kushtetuese që do të ndihmonte tranzicionin në Kosovë në drejtim të ndërtimit të një demokracie të mirëfilltë kushtetuese. Përmes këtyre dy dokumenteve, instrumentet regjionale dhe ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut u bënë e drejtë e Kosovës në tranzicion dhe mjet për ndryshim të shoqërisë kosovare përgjatë vijave të konstitucionalizmit perëndimor, krahas dispozitave mbi organizimin e pushtetit në Kosovë. Në aspektin e gjyqësisë kushtetuese, ndërkaq, **Kushtetuta e Rambujesë** ka qenë shumë më e avancuar se **Korniza Kushtetuese**.

T'i kthehemi sërish temës së lirive dhe të drejtave të njeriut si moto e **Kornizës Kushtetuese** për ndërtimin e rendit të ri kushtetues kosovar, pa çka se nuk u vu në jetë ndonjë mekanizëm për zbatimin e dispozitave të saj që përbënin kartën mbi të drejtat dhe liritë njerëzore.

Në vijim si më sipër, **Korniza Kushtetuese** në nenin 3.2 ["Të drejtat e njeriut"] theksonte si vijon:

"Institucionet e Pavarura të Vetëqeverisjes respektojnë dhe sigurojnë zbatimin e të drejtave e lirive të individit të njohura ndërkombëtarisht, përfshirë ato që parashihen në:

(a) Deklaratën Universale mbi të Drejtat e Njeriut;
(b) Konventën Evropiane për të Drejtat e Liritë e Njeriut dhe protokollet e saj;
(c) Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike dhe protokollet e saj;
(d) Konventën Evropiane për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial;

---

133 Zbatimi i drejtpërdrejtë i normave ndërkombëtare është ngushtë i lidhur me kuptimin e vetekzekutimit të normës së dhënë, pa marrë parasysh burimin e saj. Kjo është logjikë sepse një rregull zbatohet vetëm nëse ka përmbajtje normative. Kjo do të thotë se një normë ndërkombëtare, e cila gjendet në një marrëveshje ndërkombëtare, zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë vetëm nëse ka natyrë të vetekzekutueshme. Mbi zbatimin e drejtpërdrejtë të normave ndërkombëtare në aspektin komparativ, shih më shumë në Anne Peters and Ulrich K Press, "International relations and international law". Në Mark Tushnet, Thomas Fleiner and Cheryl Saunders (eds.), *Rutledge Handbook of Constitutional Law* (Routledge: Abongdon, 2012) fq. 33-44 në. fq. 39-41.

134 Zbatimi i tërthortë është i lidhur ngushtë me interpretimin e tekstit të dhënë kushtetues, gjë që nënkupton se një normë ndërkombëtare zbatohet në mënyrë të tërthortë jo për shkak se paraqet një detyrim juridik për institucionet vendore por për shkak të faktit se një interpretim i normave vendore (kushtetuese dhe ligjore) bëhet duke marrë parasysh normat dhe standardet e të drejtës ndërkombëtare. Mbi zbatimin e tërthortë të normave ndërkombëtare nga aspekti komparativ. Shih më shumë në Ibid., fq. 39-41.

135 Për një analizë të hollë të kësaj materie, shih tek Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar. Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*, fq. 391-420.

(e) Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave;
(f) Konventa për të Drejtat e Fëmijëve;
(g) Karta Evropiane për Gjuhët Regjionale dhe të Minoriteteve; dhe
(h) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Nacionale".

Menjëherë pas këtij stipulimi normohej mënyra e zbatimit të tyre nga ana e autoriteteve publike kosovare, duke përcaktuar qartë se"[...] dispozitat mbi të drejtat dhe liritë e parapara në këto instrumente zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kosovë si pjesë e kësaj **Kornize Kushtetuese**".[136] Ky stipulim, megjithatë, nuk ka arritur asnjëherë që të krijojë një efekt praktik të këtyre instrumenteve, sado që logjika mund të shpie në argumentimin se instrumentet e tilla kanë mundur të kenë një efekt të tillë. Kjo situatë në të cilën efekti praktik i drejtpërdrejtë i këtyre instrumenteve ka munguar gjatë tërë kohës sa ishte në fuqi ky dokument kushtetues ka ekzistuar edhe më herët, para se të nxirrej Korniza Kushtetuese: dispozitat e **Rregullores 1999/24** stipulonin një qasje afërsisht të njëjtë, përkatësisht synonin që e drejta ndërkombëtare mbi të drejtat dhe liritë njerëzore të konsiderohej si e zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë në tërë territorin e Kosovës. Kjo mbase ka mundur të bëhet kur flitet për ato norma që kishin natyrën e normave të vetekzekutueshme: zbatimi i tyre i tërthortë përmes interpretimit të tyre konform standardeve të njohura ndërkombëtarisht mbi liritë dhe të drejtat njerëzore përbënte një detyrim, që tani buronte jo vetëm nga neni 3.2 si më sipër, por edhe nga rregullativa tjetër e nxjerrë nga **UNMIK**-u gjatë kohës sa ka administruar efektivisht me Kosovën.[137]

Normat ndërkombëtare mbi të drejtat dhe liritë njerëzore kanë qenë pjesë përbërëse e rendit juridik kosovar që nga nxjerrja e rregulloreve të ndryshme të **UNMIK**-ut, të cilat si tërësi kishin për qëllimin reformimin e sistemit juridik-kushtetues sipas standardeve më të larta ndërkombëtare të demokracive kushtetuese. Si zbatimi i drejtpërdrejtë ashtu dhe ai i tërthortë, përmes interpretimit të teksteve juridike të rëndësisë kushtetuese, nuk kanë qenë kontestuese sepse ky zbatim ka qenë një detyrim kushtetues për të gjitha autoritetet publike kosovare. Në praktikë, megjithatë, situata ka qenë më ndryshe: të pakta kanë qenë institucionet e Kosovës që kanë marrë seriozisht vënien në jetë të një detyrimi të tillë. Kjo gjendje nuk pati ndonjë përmirësim as me inicimin e projektit të a.q. **Standardet para Statusit** (dhjetor të vitit 2003).

Me këtë projekt, të nisur nga **Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm** (PSSP), autoritetet e **UNMIK**-ut synonin implementimin e një kulture të gjallë për liritë dhe të drejtat e njeriut në institucionet vendore dhe në akterët tjerë vendorë me qëllim që në një afat të mesëm të vinte deri te mbjellja e një demokracie kushtetuese kosovare.[138] Këto përpjekje kësisoj, në një mënyrë ose tjetër, bëheshin me qëllim

[136] Neni 3.3 ["Të Drejtat e Njeriut"] i Kornizës.

[137] Po aq e rëndësishme është edhe rregullorja e UNMIK-ut që ka të bëjë me të drejtat dhe liritë fundamentale të individit, **Rregullorja Nr. 24/1999** mbi Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë e datës 12 dhjetor 1999. Në seksionin 1.3 lidhur me "ligjin e zbatueshëm", Rregullorja përdorte të njejtin formulim si neni 3.2 i **Kornizës Kushtetuese,** duke listuar gati të njëjtat instrumente ndërkombëtare si burim të ligjit mbi të drejtat e njeriut në Kosovë. I vetmi përjashtim është se kjo rregullore listonte nën germën "d", përveç instrumenteve nga neni 3.2 i **Kornizës Kushtetuese** edhe Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore të 16 dhjetorit 1966.

[138] Në dhjetor të vitit 2003, bashkësia ndërkombëtare përmes **PSSP-së**, zt. **Hari Holker** (Harri Holkeri (1937-2011), i cili ka shërbyer si shef i **UNMIK**-ut gjatë viteve 2003-2004, ua dorëzoi autoriteteve kosovare dokumentin **Standardet për Kosovën**. Dokumenti përmbante detyrat kryesore qe Kosova duhej t'i realizonte deri ne vitin 2005, ne mënyrë qe pastaj të vlerësoheshin arritjet dhe nëse gjykohet se "standardet janë përmbushur", do te iniciohej faza e ardhshme e përcaktimit te statusit final te **Kosovës**. Në ballinën e këtij dokumenti shkruante që synohej krijimi, **inter alia**, i një Kosovë ku të gjithë, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, racën ose fenë, janë të lirë të jetojnë, punojnë dhe udhëtojnë pa frikë, armiqësi ose rreziqe dhe ku ka tolerancë, drejtësi dhe paqe për të gjithë".Që nga bërja publike e këtij dokumenti, çdo kërkesë e shqiptarëve për zgjidhjen e statusit merrte përgjigje nga ndërkombëtarët se standardet ishin para statusit. Kjo është arsyeja pse në publik edhe njihen më shumë si **Standardet para Statusit**, ani se titulli i dokumentit, siç shihet, ka qenë i ndryshëm.Dokumenti **Standardet për Kosovën** përmbante tetë pika:

- themelimi i institucioneve demokratike funksionale;
- ndërtimin e një rendi ku mbretëron sundimi i ligjit;

që të fitohej kohë, përkatësisht me synim që të shtyhej sa më shumë që të jetë e mundur zgjidhja e statusit përfundimtar të Kosovës, gjithnjë me shpresë se, pas një kohe të zbatimit të këtyre standardeve, mund të vijë deri të krijimi i një klime tjetër më e favorshme për negociata rreth statusit. Kjo shpërputhje në mes të realitetit të normave dhe përpjekjeve të **UNMIK**-ut për realizimin e projektit **Standardet para Statusit** u pa hapur kur ndodhën ngjarjet tragjike të marsit 2004, të cilat, gjithashtu, i diskutojmë në vijim të këtij seksioni.

Për zhvillimin e të drejtës kushtetuese kosovare në këtë periudhë, sikundër u tha më sipër, me rëndësi janë edhe këto dokumente:[139]

- **Rezoluta 1244;**
- **Rregullorja nr. 1999/1;**[140]
- **Rregullorja nr. 1999/24;**[141]
- **Korniza Kushtetuese;**
- **Raporti i Kai Eide** (2004);[142]
- **Plani Ahtisari;**
- **Deklarata e Pavarësisë**; dhe
- **Mendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Kosovën**.[143]

Rezoluta 1244 është dokumenti i parë i bashkësisë ndërkombëtare me natyrë juridiko-politike që është marrë me organizimin e brendshëm të Kosovës. Ajo ka autorizuar organet e **OKB**-së për themelimin e një misioni civil ndërkombëtar.[144] Për dallim nga **Marrëveshja e Rambujesë,** që asnjëherë nuk hyri në fuqi ashtu siç parashikohej, rezoluta gëzon fuqinë e plotë të një akti juridiko-politik që nxirret sipas **Kapitullit VII** të **Kartës së OKB**-së. Natyrën e vet juridiko-politike e fiton sipas përcaktimit të disa të drejtave dhe detyrimeve për palët në konflikt, shqiptarët dhe serbët, si dhe për vetë bashkësinë ndërkombëtare. Kjo e fundit, bashkësia ndërkombëtare, detyrohej që të siguronte paqen dhe sigurinë për të gjithë, të formojë institucionet

---

- promovimi dhe sigurimi i lirisë së lëvizjes;
- kthimet e qëndrueshme dhe të drejtat e bashkësive dhe pjesëtarëve të tyre;
- ekonomia e qëndrueshme;
- të drejtat pronësore të garantuara;
- dialogu ndëretnik dhe ai me Serbinë; dhe, së fundit,
- reformimi **Trupave Mbrojtëse të Kosovës** (TMK).Në fillim, shqiptarët si popull shumicë, e kuptuan se përmbushja e standardeve ishte e domosdoshme për fillimin e bisedimeve për statusin e Kosovës, por shumë nga standardet ishin të vështira për Kosovën për t'u përmbushur, për disa arsye: e para, sepse vënia e disave prej tyre në jetë kërkonte organe vendore me kompetenca të plota për të vepruar, gjë që nuk e kishin **Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë** (IPVQ) si pasojë e faktit se **UNMIK**-u mbante tërë pushtetin në duart e veta; e dyta, për shkak se serbët, të frikësuar nga rezultati i bisedimeve, sabotonin këto standarde, duke mos marrë pjesë në ndërtimin e institucioneve demokratike të **Kosovës**; e treta, në të njëjtën kohë, bashkësia ndërkombëtare pohonte se standardet që kanë të bëjnë komunitetet e **Kosovës** ishin më të rëndësishmet.

Shqiptarët, si popull shumicë, shihnin çdo negocim si diçka formale dhe që duhej kryer vetëm sa për të realizuar një vullnet për dialogim me serbët sepse rezultati përfundimtar duhet të ishte pavarësia e plotë përmes deklarimit të vullnetit të popullit, ashtu siç është premtuar në pikën e tretë të nenit të parë të kapitullit të tetë dhe të fundit të **Marrëveshjes së Rambujesë**.

139 **Deklaratën e Pavarësisë** dhe **Kushtetutën e vitit 2008** i diskutojmë në seksionin 5.2., **infra.**

140 *REGULATION NO.1999/1.UNMIK/REG/1999/1.25 July 1999 ON THE AUTHORITY OF THE INTERIM ADMINISTRATION IN KOSOVO.* **Në internet:** http://www.unmikonline.org/regulations/1999/re99_01.pdf (shikuar në mars 2022).

141 *REGULATION NO. 1999/24.UNMIK/REG/1999/24. 12 December 1999. ON THE LAW APPLICABLE IN KOSOVO.* **Në internet:** http://www.unmikonline.org/regulations/1999/re99_24.pdf.

142 Letter dated 17 November 2004 from the Secretary-General addressed to the President of the Security Council. Report on the situation in Kosovo.*United Nations.* S/2004/932- Security Council Report. 30 November 2004. Në internet: http://www.securitycouncilreport. org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/kos %20S2004%20932.pdf (shikuar në mars 2022).

143 *ACCORDANCE WITH INTERNATIONAL LAW OF THE UNILATERAL DECLARATION OF INDEPENDENCE IN RESPECT OF KOSOVO ADVISORY OPINION OF 22 JULY 2010*. Në internet: http://www.icj-cij.org/files/case-related/141/141-20100722-ADV-01-00-EN.pdf (shikuar së fundi mars 2022).

144 Cf. pikat 5-8 dhe 10-11 të **Rezolutës 1244**.

vendore të vetëqeverisjes lokale dhe, në fund, të ndërmjetësojë në procesin e gjetjes së një zgjidhjeje politike për statusin përfundimtar të **Kosovës**.

Sa i përket vetëqeverisjes në **Kosovë**, rezoluta konceptualisht nuk ka qenë shumë larg **Marrëveshjes së Rambujesë**, nisur nga fakti se në mënyrë shprehimore theksonte që parimet e saj do të merren parasysh në periudhën transitore të ndërtimit të sistemit të vetëqeverisjes, deri në arritjen e një marrëveshjeje politike në mes të palëve për statusin final.[145] Për një **konstitucionalizëm** të tipit bashkëkohor, ku supremacia (epërsia) e kushtetutës përbën postulatin thelbësor, as që mund të bëhet fjalë në këtë kohë nga shkaku se **Rezoluta 1244** paraqet manifestim të vullnetit të bashkësisë ndërkombëtare, jo të popullsisë vendore. Ky vullnet i bashkësisë ndërkombëtare, i shprehur përmes **KS** si një organ politik i **OKB**-së, ka parasysh mbrojtjen e vlerave dhe postulateve tjera nga ato që kanë të bëjnë me konstitucionalizmin bashkëkohor. Ato vlera dhe postulate kanë pasur të bëjnë me garantimin e sigurimit të integritetit dhe sovranitetit territorial të RFJ-së, të paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, si dhe ndërtimi i institucioneve të vetëqeverisjes lokale. **Rezoluta 1244** shumë pak flet për promovimin e lirive dhe të drejtave njerëzore.[146]

Në hierarkinë e këtyre vlerave dhe postulateve të sanksionuara me **Rezolutën 1244**, fuqinë më të madhe e kanë dispozitat për sigurimin dhe ruajtjen e integritetit dhe sovranitetit territorial të **RFJ**-së, si një shtet sovran dhe i pavarur. Kjo për shkak se dokumenti i takon KS të **OKB**-së dhe është nxjerrë sipas autorizimeve nga kapitulli VII i **Kartës së OKB**-së.[147] Në këtë kontekst, duhet vërejtur se nuk ka pasur asnjë mundësi që të flitet për sigurimin e supremacisë (epërsisë) së ndonjë dokumenti juridik-kushtetues vendor sepse të tillë nuk ka pasur: ka qenë fuqia e kësaj rezolute që ka qëndruar në maje të teksteve të tjera të natyrës juridiko-kushtetuese të nxjerra nga organet vendore, në cilën do periudhë në të kaluarën.

Kjo qasje, pra qasja që i jep supremaci (epërsi) një teksti ndërkombëtar, që miratohet nga bashkësia ndërkombëtare apo në emër të saj, në këtë rast nga KS i OKB-së, nuk është e re për Kosovën. Kështu përcaktohej edhe me **Marrëveshjen e Rambujesë.**[148] Në dy këto dokumente vullneti i vendorëve dhe organizimi i brendshëm duhej t'i nënshtroheshin dispozitave dhe urdhrave ndërkombëtare. Organi që siguronte këtë supremaci (epërsi) në dy rastet nuk ishte gjykata vendore, por **KS** si organ politik i **OKB-**së. Ajo çfarë ngjason me konstitucionalizmin modern, në Kosovë nis me **Marrëveshjen e Rambujesë**, jo me **Rezolutën 1244**. Kjo e fundit, vetëm në një vend bënë fjalë për të drejta të njeriut.[149] Vetëm më pastaj, nën autoritetin e **UNMIK**-ut janë nxjerr dokumentet të natyrës juridike që kanë normuar aspekte kushtetuese të lirive dhe të drejtave të njeriut. Në këtë kuptim mund të thuhet se, në aspektin material, dokumentet e **UNMIK**-ut mbi liritë dhe të drejtat e njeriut kanë karakter kushtetues. Ky fakt bënë që të njëjtat të ngjasojnë me **konstitucionalizmin modern**, u mor vesh gjithnjë bëhet fjalë për ngjasim në aspektin e jashtëm të rregullimit normativ.

---

145 "[…]"**Këshilli i Sigurimit**,**...**
11. Vendos që përgjegjësitë kryesore të pranisë civile ndërkombëtare të përfshijnë:
e) Të ndihmohet një proces politik me qëllim të përcaktimit të statusit të ardhshëm të Kosovës, duke marrë parasysh marrëveshjet e Rambujesë (S/1999/648);
f) Në një fazë përfundimtare, mbikëqyrjen e kalimit të pushtetit nga institucionet e përkohshme të Kosovës tek institucionet e themeluara me marrëveshje politike; […]. **Rezoluta 1244**.

146 Në fakt, **Rezoluta 1244** flet për liritë dhe të drejtat njerëzore vetëm në një vend, në pikën 11 nën "j", ku theksohej se prania civile ndërkombëtare, **UNMIK**-u, do të kujdeset për "mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të njeriut".

147 Në fakt, **Rezoluta 1244** flet për liritë dhe të drejtat njerëzore vetëm në një vend, në pikën 11 nën "j", ku theksohej se prania civile ndërkombëtare, **UNMIK**-u, do të kujdeset për "mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të njeriut".

148 Cf. pikën 6 të nenit të parë të pjesës kuadër të **Marrëveshjes së Rambujesë** që përcaktonte se, në rast mospajtimi, do të vlente Marrëveshja ashtu që palët duhej të harmonizonin të gjitha aktet juridike dhe veprimet tjera në pajtim me këtë. Sikundër u pa me zhvillimin kushtetues shqiptar, e njëjta kishte ndodhur me **Statutin e Përkohshëm të Këshillit Ndërkombëtar të Kontrollit** (**KNK**), i proklamuar më 10 prill 1914. Ky dokument shpërfaqte ushtrimin e pushtetit konstituiv nga ana e faktorit ndërkombëtar.

149 Cf. pikat 5-8 dhe 10-11 të **Rezolutës 1244.**

Ky ngjasim ka të bëjë me rolin dhe vendin e individit në shoqërinë e re kosovare, diçka që ka qenë e reflektuar në secilin prej këtyre dokumenteve ndërkombëtare si më sipër. Ky synim i bashkësisë ndërkombëtare për t'ia njohur individit në Kosovë një rol dhe një pozitë krejtësisht të re, shumë më të avancuar dhe më të ndryshme në pikëpamje kualitative në krahasim me çdo fazë tjetër të zhvillimit të **Kosovës,** diskutohet në hollësi në vijim pas diskutimit tonë lidhur me dokumentet bazë me rëndësi kushtetuese të nxjerra nën autoritetin e **OKB**-së në kohën deri te shpallja e pavarësisë së **Kosovës**.

Analizën e këtyre e dokumenteve me rëndësi kushtetuese e bëjmë duke u nisur nga rëndësia që ato kanë pasur për organizimin e jetës juridike dhe politike, sociale, ekonomike dhe kulturore në **Kosovë** pas datës 10 qershor 1999. Në këtë bënë pjesë edhe analiza e mendimit këshillëdhënës për **Kosovën** të **GJND**, dokument ky me një rëndësi të madhe për konsolidimin e shtetësisë kosovare në planin ndërkombëtar. Në këtë mendim, **GJND-ja** ka analizuar në mënyrë jashtëzakonisht të saktë natyrën juridike të dokumenteve të nxjerra nga administrata e përkohshme e **UNMIK-**ut, duke konstatuar se rendi kushtetues i **Kosovës** pas shpalljes së pavarësisë së saj më 17 shkurt 2008, është i ndryshëm nga rendi juridik i krijuar nga bashkësia ndërkombëtare pas datës 10 qershor 1999. Ka edhe një arsye tjetër pse analizojmë këto dokumente në këtë seksion, arsye që ka të bëjë me faktin se në këtë periudhë as që mund të flitet për ndonjë gjyqësi kushtetuese sepse nuk ekziston një tekst burimor kushtetues supremacia (epërsia) e të cilit kundrejt çdo teksti tjetër do të duhej siguruar përmes një mekanizimi institucional të quajtur gjykatë kushtetuese apo gjykatë tjetër e barasvlershme me të. Kjo supremaci (epërsi) e dokumenteve juridike të bashkësisë ndërkombëtare ndaj çdo akti tjetër juridik ekzistues në **Kosovë** është prezumuar, përkatësisht është marrë si diçka e mirëqenë. Me fjalë të tjera, supremacia (epërsia) e dokumenteve ndërkombëtare në **Kosovë** nga data 10 qershor 1999 është realizuar përmes veprimit të përditshëm rutinor të administratës së **UNMIK**-ut.

Të shohim në vijim se cila ka qenë përmbajtja e këtyre dokumenteve. Përmes kësaj analize lexuesi ynë mund të shohë nga afër **evoluimin e të drejtës kushtetuese kosovare** nga një e drejtë administrative ndërkombëtare e ushtruar nga burokracia e **UNMIK**-ut në një të drejtë të mirëfilltë kushtetuese të ndërtuar sipas modelit të demokracive kushtetuese liberale të proveniencës perëndimore.

Në kuptim hierarkik, **Rezoluta 1244** paraqet "kushtetutën" e **Kosovës** së pasluftës sepse ka qenë dokumenti me fuqi më të lartë juridiko-politike dhe themel i çdo akti juridik (të përgjithshëm apo individual) të nxjerrë nga **UNMIK**-u deri në shpalljen e pavarësisë më 17 shkurt 2008. Ndër aktet juridike të nxjerra në vijim të zbatimit të zotimeve të Rezolutës, dy kanë rëndësi të veçantë për diskutimin tonë në këtë libër: **Rregullorja Nr. 1991/1** dhe **Rregullorja Nr. 1999/24**. Aktet juridike në formë të rregulloreve kanë paraqitur aktivitetin primar ligjvënës të **PSSP**-së.

Dokumenti i parë i nxjerrë nga **PSSP-ja** në emër të **OKB-**së ka qenë **Rregullorja nr. 1999/1**. Bazat dhe qëllimet për nxjerrjen e kësaj rregulloreje janë dhënë në vetë tekstin e preambulës së saj. Bazat dhe qëllimet që i kanë shërbyer **PSSP**-së si udhëzues me rastin e nxjerrjes së këtij dokumenti kanë qenë dy:

- e para, autorizimi të cilin **KS** ia ka bartur Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në bazë të kapitullit të VII të **Kartës së OKB**-së për të formuar, me ndihmën e organizatave relevante ndërkombëtare, një prani civile ndërkombëtare, e njohur si **UNMIK**, me qëllim që administrata e tillë të vishet me një mandat të përcaktuar me **Rezolutën 1244,** 113 dhe
- e dyta, autorizimi që **PSSP** ka marrë sipas **Rezolutës 1244** me qëllim të themelimit dhe mbajtjes së një administrate të përkohshme në **Kosovë.**[150]

Rregullorja ka specifikuar se cili është qëllimi i pushtetit të administratës së përkohshme të OKB-së në Kosovë, kush dhe si e ushtron atë pushtet dhe në emër të kujt. Ky pushtet, sipas kësaj rregulloreje, kon-

[150] Cf. pika 11 prej gërmës "a" deri në germën "d" e **Rezolutës 1244**.

siderohej se ka lindur dhe është krijuar që nga data 10 qershor 1999, datë kur është miratuar **Rezoluta 1244**.[151]

Sipas seksionit 1.1 ["Autoriteti i Administratës së Përkohshme"] të Rregullores krejt autoriteti legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor në Kosovë i takon **UNMIK**-ut dhe ushtrohet nga ana **PSSP**-së. Ky i fundit, sipas pikës 1.2 të seksionit të njëjtë, ka pasur të drejtën e caktimit të çdo personi në çdo pozitë, si dhe largimin e tyre, përfshirë këtu caktimin e gjyqtarëve. Ushtrimi i këtij autoriteti kaq të madh dhe krejt të pakufizuar në aspektin formal e material nga ana e **PSSP-së**, megjithatë, ka pasur disa kufij brenda të cilëve është dashur të ushtrohet. Këta kufij brenda të cilëve **PSSP-ja** ka qenë i detyruar të ushtrojë tri pushtetet si më sipër, kanë qenë të përcaktuar me seksionin 3 ["Ligji i Aplikueshëm në Kosovë"] të Rregullores. Sipas kësaj dispozite, si përbërës të ligjit të aplikueshëm në **Kosovë** janë konsideruar:

- aktet juridike që kanë qenë të vlefshme në Kosovë para datës 24 mars 1989. Kjo datë konsiderohet si datë kur **Kosova** ka humbur autonominë e saj legjislative, ekzekutive-administrative dhe gjyqësore që e gëzonte sipas **Kushtetutës së vitit 1974.** Në këto dispozita janë përfshirë të gjitha aktet juridike të nxjerra nga organet kompetente të **Kosovës**, si dhe ato të organeve të **Republikës së Serbisë** dhe të organeve të **RSFJ-së** në rastet kur për ekzekutimin dhe vënien e tyre në jetë, kanë qenë kompetente dhe të ngarkuara organet e **Kosovës**;
- aktet juridike si më sipër kanë pasur atë vlerë sipas seksionit 2 ["Respektimi i Standardeve të Njohura Ndërkombëtarisht"] të Rregullores, por vetëm me kusht që ato nuk binin ndesh me standardet e njohura ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe nuk ishin diskriminuese mbi bazat si vijon: seksi, raca, ngjyra, gjuha, religjioni, mendimi politik ose mendimit tjetër, origjina nacionale, etnike apo sociale, asocimi me ndonjë komunitet nacional, prona, lindja apo ndonjë status tjetër.

Çështja e supremacisë (epërsisë) së akteve legjislative të **UNMIK**-ut, të cilat kanë pasur formën e rregulloreve, sanksionohej me seksionin 4 ["Rregulloret e Nxjerra nga UNMIK"] të Rregullores. Aty përcaktohej qartë se këto akte me karakter legjislativ kanë mundur të shfuqizohen vetëm përmes nxjerrjes së akteve të natyrës së njëjtë. I vetmi përjashtim nga kjo rregull, i cili parashikohej në këtë seksion, ka pasur të bëjë me aktet që mund t'i nxirrnin në të ardhmen institucionet e themeluara sipas marrëveshjes politike në mes të palëve, **Prishtinës** dhe **Beogradit**, ashtu siç parashihet me **Rezolutën 1244**. Kjo marrëveshje politike, skundër dihet, nuk është arritur meqenëse serbët kanë refuzuar të njohin **Planin Ahtisari** kurse **Kosova**, pikërisht mbi bazën e këtij plani, ka shpallur pavarësinë e saj më datën 17 shkurt 2008. Kjo rrethanë shpjegon se përse në **Kushtetutën e vitit 2008**, në dispozitat që tanimë janë fshirë ngaqë janë tejkaluar me momentin e mbylljes së pavarësisë së mbikëqyrur në shtator të vitit 2012, kanë ekzistuar stipulimet që ua njihnin fuqinë juridike rregulloreve dhe akteve tjera të **UNMIK**-ut deri në zëvendësimin e tyre nga ligjvënësi kosovar.[152] Në fakt, këto dispozita janë futur në Kushtetutë në vijim të zbatimit të **Plani Ahtisari** si pjesë e detyrimeve të njëanshme që i ka marrë Kosova për shpalljen e pavarësisë së saj dhe njohjen ndërkombëtare nga ana e shumicës së shteteve të botës së sotme.[153]

---

151 Seksioni 7 ["Hyrja në fuqi "] e Rregullores: "Kjo rregullore konsiderohet se ka hyrë në fuqi më datën 10 qershor 1999, ditën e miratimit të Rezolutës 1244 të KS të OKB (1999)".

152 Neni 145 ["Vazhdimësia e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe e Legjislacionit të Aplikueshëm"] i Kushtetutës: "[…] 2. Legjislacioni i aplikueshëm në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute vazhdon të zbatohet për aq sa të jetë në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë, derisa të mos shfuqizohet, zëvendësohet ose amendamentohet në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë".

153 Neni 146 ["Aranzhmanet Kalimtare dhe Dispozitat Përfundimtare "] i **Planit Ahtisari**:
"[…] 14.2.1 Rregulloret e UNMIK-ut të shpallura nga ana e PSSP-së, në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244, përfshirë urdhëresat administrative dhe vendimet ekzekutive të nxjerra nga PSSP-ja dhe ligjet e shpallura të miratuara nga Kuvendi i Kosovës do të vazhdojnë së zbatuari, përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, deri në skadimin e vlefshmërisë së tyre, apo deri në anulimin apo zëvendësimin e tyre me legjislacionin që rregullon të njëjtën çështje në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje[…]".

Dokumenti i dytë i nxjerrë nga **PSSP-ja** në emër të **OKB**-së ka qenë **Rregullorja nr. 1999/24**. Edhe kjo rregullore me rëndësi juridike-kushtetuese konsiderohet se është nxjerrë më datën 10 qershor 1999. Me të, më tutje, janë specifikuar parametrat e ligjit të aplikueshëm në Kosovë: fillimisht afirmohet momenti kohor për ligjin e aplikueshëm në Kosovë, përkatësisht caktohet se i aplikueshëm do të konsiderohet ai ligj që ka qenë në fuqi në **Kosovë** para datës 24 mars 1989, në mënyrë të njëjtë siç përcaktohej me rregulloren paraprake të diskutuar më sipër. Edhe më këtë rregullore parashikohej mundësia që të zbatoheshin dispozitat tjera në fuqi në **Kosovë** pas datës 24 mars 1989, por vetëm me një kusht-që ato dispozita mos të kenë natyrë dhe përmbajtje diskriminuese.

Për dallim nga rregullorja paraprake, kjo në mënyrë më të qartë dhe specifike përcakton parametrat objektivisht të matshëm për standardet ndërkombëtare të zbatueshme në lëmin e lirive dhe të drejtat e njeriut, të cilat çdo autoritet publik apo individ që ushtron funksion publik në Kosovë ishte i detyrueshëm për t'i vënë në jetë. Kjo bëhet e qartë nga redaktimi i seksionit 1.3 ["Ligji i Aplikueshëm"] të Rregullores ku përcaktohej se të gjitha autoritetet publike apo individët që ushtrojnë funksione publike detyroheshin të respektonin standardet ndërkombëtarisht të njohura mbi të drejtat e njeriut, ashtu siç janë reflektuar në mënyrë të veçantë në këto dokumente:

- Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut të datës 10 dhjetor 1948;
- Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut të datës 4 nëntor 1950 dhe Protokollet e saj;
- Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike e datë 16 dhjetor 1966 dhe Protokollet e saj;
  Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore e datës 16 dhjetor 1966;
- Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor e datës 21 dhjetor 1965;
- Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor kundër Grave e datës 17 dhjetor 1979;
- Konventën kundër Torturës dhe Formave tjera të Trajtimit të Shëmtuar, Jonjerëzor dhe Poshtëruese datës 17 dhjetor 1984; dhe
- Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve e datë 20 dhjetor 1989.

Edhe në këtë rregullore sforcohet detyrimi i ndjekjes së politikave jodiskriminiuese në **Kosovë** nga të gjitha autoritetet publike dhe individët që ushtrojnë funksione publike. Kjo shihet nga redaktimi i dispozitës së njëjtë si në rregulloren paraprake, përkatësisht nga redaktimi i dispozitës së seksionit 1.4 të Rregullores, ku thuhej si vijon:

"Asnjë person, që ushtron funksion publik apo mban ndonjë pozitë publike në Kosovë, nuk guxon të diskriminojë asnjë person mbi asnjë bazë, siç janë: gjinia, raca, ngjyra, gjuha, religjioni, bindjet politike ose tjera, prejardhja natyrore, sociale apo etnike, asocimi me ndonjë bashkësi nacionale, prona, lindja apo statusi tjetër […]".

Për dallim nga rregullorja paraprake, kjo rregullore përcakton disa standarde rreth sigurimit të supremacisë (epërsisë) së saj dhe të akteve tjera legjislative të nxjerra nga **UNMIK**-u, përkatësisht nga **PSSP-ja** si i vetmi organ i autorizuar për një gjë të tillë. Seksioni 2 ["Implementimi"] i saj përcaktonte si vijon:

"Gjykatat në Kosovë mund të kërkojnë sqarim nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me implementimin e kësaj rregulloreje. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm do të ofrojë një sqarim të tillë me qëllim që gjykatat ta kenë parasysh gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre".

Nga kjo dispozitë shihet qartë se fjala ka qenë për interpretim të detyrueshëm të dispozitave nga ana e vetë autorit të tyre, **PSSP**-së, me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së të njëjtave kundrejt

çdo dispozite tjetër të aplikueshme në Kosovë. Se kjo është kështu bëhet edhe më e qartë nga përmbajtja e dispozitës së seksionit 1.1 ["Ligji i Aplikueshëm"], në të cilën thuhet se rregulloret dhe instrumentet tjera të nxjerra nga **PSSP-ja** gëzojnë supremaci (epërsi) ndaj ligjit që ka qenë i aplikueshëm në Kosovë para datës 24 mars 1989, në rast të konfliktit në mes tyre.
Korniza Kushtetuese paraqet dokumentin më përmbledhës juridiko-kushtetues, i nxjerrë nga UNMIK-u në vijim të zbatimit të detyrës së tij kryesore që e kishte marrë mbi vete konform **Rezolutës 1244**. Ajo detyrë konsistonte në ndërtimin e institucioneve të vetëqeverisjes në vend deri në themelimin e atyre të përhershme që pritej të ndodhte si rezultat e një marrëveshjeje politike në mes të palëve, diçka që nuk ndodhi asnjëherë. Edhe ky dokument ka formën standarde përmes së cilës **PSSP**-ja ka ushtruar kompetencat e veta sipas **Rezolutës 1244**, përkatësisht formën e rregullores. Kjo rregullore mban numrin **2001/9** dhe është nënshkruar nga **PSSP**-ja më datën 15 maj 2001.

Si në preambulë ashtu edhe në pjesën operative të Kornizës, në syprinë dalin dy qëllime për të cilat është nxjerrë ky dokument me shumë rëndësi për zhvillimin kushtetues të **Kosovës** dhe për historinë e saj bashkëkohore. Si qëllim i parë del organizimi i vetëqeverisjes në **Kosovë** përmes krijimit të **Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes** (**IPVQ),** kurse i dyti konsiston në krijimin e kushteve të duhura për gjetjen e një zgjidhjeje përfundimtare për statusin e ardhshëm të Kosovës.[154]

IPVQ-të në Kosovë kanë mbuluar fushat legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe janë themeluar përmes procedurave demokratike të pjesëmarrjes së popullit të Kosovës në zgjedhjet e lira dhe të drejta. Në këtë kontekst, ndarja e pushtetit ka qenë ndër postulatet themelore të sipas të cilit kanë punuar ato, diçka që po ndodhte për herë të parë në Kosovë, së paku në aspektin formal të kuptimit të ndarjes së pushteteve. Ky proklamim i ndarjes së pushteteve, megjithatë, nuk ka mundur të jetë kuptimplotë: **PSSP**-ja ende ruante kompetencat e veta sipas **Rezolutës 1244** dhe **Rregullores nr. 1999/1** si më sipër, përkatësisht kompetencat legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në tërë territorin e Kosovës. Kjo reflektohej edhe në tekstin e Kornizës ku flitej për secilën nga këto kompetenca: **PSSP-ja** kishte kompetencë për shpërndarje të kuvendit çdo herë kur vërente se veprimet e legjislativit kosovar binin ndesh me **Rezolutën 1244**,[155] ekzekutivi i Kosovës duhej të vepronte me shumë kujdes sepse fjalën e fundit në çështjet ekzekutive sërish e kishte **PSSP**-ja,[156] dhe, në fund, gjyqësori i **Kosovës** duhej ta kryente punën e vet në bazë të ligjit të aplikueshëm ashtu siç definohej ky term në **Rregullores Nr. 1999/24** kurse të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët emëroheshin dhe shkarkoheshin nga vetë **PSSP**-ja.[157]

Këto zgjidhje, si më sipër, janë krejt të natyrshme, nisur nga fakti se supremacia (epërsia) absolute në instancë të fundit i takonte vetëm **Rezolutës 1244**, e cila shërbente si bazë për vlerësim të ligjshmërisë së gjithë aktivitetit politiko- juridik dhe tjetër në Kosovë. Në kushtet e një administrimi ndërkombëtar, siç ka qenë rasti me **Kosovën**, kontrolli i kushtetutshmërisë do të nënkuptonte sigurimin e supremacisë (epërsisë) së një teksti të brendshëm kushtetues, **Kornizës Kushtetuese**, që kishte autorësi ndërkombëtare dhe shprehte vullnetin ndërkombëtar ngaqë shpallja e saj bëhej në emër të KS të OKB-së nga ana e PSSP-së. Një situatë e tillë, sikur të ekzistonte teorikisht, do të përbënte një absurd dhe një zgjidhje jologjike sipas standardeve dhe parametrave të **konstitucionalizmit bashkëkohor**. Një kontroll i tillë, thënë me fjalë tjera, do të nënkuptonte të drejtën e Kosovës që përmes një organi të brendshëm të kryente kontrollin e kushtetutshmërisë së vullnetit politik të një organi politik ndërkombëtar që quhet **KS** të **OKB-**së. Kjo nuk mund të ketë asnjë kuptim sepse organ gjyqësori i **OKB**-së është **GjND-ja** dhe asnjë organ tjetër, në ndërkohë që gjykatat apo organet tjera nacionale në asnjë rrethanë nuk mund të ushtrojnë kontrollin e kushtetutshmërisë së akteve dhe veprimeve të asnjërit prej organeve të **OKB**-së.

---

154 Cf. Preambulën e **Rregullores nr. 2001/9** dhe Preambulën e **Kornizës Kushtetuese**.

155 Cf. dispozitën e paragrafit 8.1, germa "b" e kreu 8-të [" Kompetencat dhe përgjegjësitë e rezervuara për PSSP-në "] të **Kornizës Kushtetuese**.

156 Cf. dispozitën e paragrafit 8.1 nga germa "c" deri në "dh", si dhe nga germa "g" deri në "s" të kreut 8-të ["Kompetencat dhe përgjegjësitë e rezervuara për PSSP-në "] të **Kornizës Kushtetuese.**

157 Cf. dispozitën e paragrafit 8.1, germat "e" dhe "ë" të kreut 8-të [" Kompetencat dhe përgjegjësitë e rezervuara për PSSP-në "] të **Kornizës Kushtetuese.**

Raporti **Kai Aide** përbën pikën e kthesës në fazën e përcaktimit të statusit të Kosovës sipas zotimeve të marra me **Rezolutën 1244**. Raporti u bë sipas mandatit të dhënë nga Sekretari i Përgjithshëm i **OKB-së** dhe vinte si rezultat i drejtpërdrejtë i ngjarjeve tragjike të datës 17 dhe 18 mars 2004. Në këto ngjarje humbën jetën 11 shqiptarë, tetë serbë, u plagosën më mijëra të tjerë, pjesëtarë të **KFOR**-it, **UNMIK**-ut dhe të **Policisë së Kosovës**, si dhe u shkatërruan e u dogjën me mijëra shtëpi, prona private dhe objekte të trashëgimisë kulturore e fetare të komuniteteve joshqiptare, kryesisht të komunitetit serb të **Kosovës**.[158]

Marti Ahtisari u caktua në nëntor të vitit 2005 si përfaqësues special i **OKB-së** për **Kosovën**, i mandatuar me mision të qartë për të analizuar situatën në terren, për të ndërmjetësuar në mes të palëve dhe, në fund, për të dhënë një propozim lidhur me statusin përfundimtar që Kosova do të duhej ta kishte në të ardhmen. Ky mandat bazohej në **Rezolutën 1244**. Pas shumë bisedimeve dhe negociatave të ndërmjetësuara nga ai dhe ekipi i tij i shkëlqyer,[159] në fillim të vitit 2007, presidenti i **KS** të **OKB**-së e qarkulloi një dokument që përmbante propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Ky dokument që nga kjo kohë u njoh me emrin **Plani Ahtisari** [160] dhe ishte i ndarë nga një letër, të cilën **Marti Ahtisari**, përmes Sekretarit të Përgjithshëm të **OKB**-së e dërgoi në **KS** të **OKB**-së për miratim. Në letër përmbaheshin rekomandimet konkrete për zgjidhjen përfundimtare të statusit të Kosovës: aty theksohej se pavarësia e mbikëqyrur e Kosovës ishte opsioni i vetëm për zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës, duke marrë parasysh historinë violente dhe vuajtjet e popullsisë shumicë nga regjimi i diktatorit **S. Millosheviq**, si dhe kohën e gjatë të administrimit ndërkombëtar të **Kosovës** dhe vetë natyrën specifike të stipulimeve të **Rezolutës 1244**. Këto rrethana e bënin rastin e Kosovës dhe pavarësinë e saj si një rast **sui generis**.[161] Në të njëjtën kohë, **Serbia** dhe delegacioni serb në bisedime gjatë tërë kohës së zhvillimit të tyre në **Vjenë**, mbi 15 muaj, përgjatë viteve 2005-2007, qëndroi pasiv, duke besuar se e drejta klasike ndërkombëtare do të mbronte pafundësisht dhe pa asnjë kusht sovranitetit dhe integritetin territorial të **RFJ-së,** asetet dhe të drejtat e saj në territorin e **Kosovës**, identitetin shtetëror në raport me botën e jashtme dhe kështu me radhë.[162]

Kjo mbikëqyrje e pavarësisë së Kosovës ka mbaruar në shtator të vitit 2012, ani se në dispozitat e Planit nuk qe përcaktuar një datë e saktë se kur do të duhej të ndodhte një gjë e tillë.[163] Ndër dispozitat

---

158 Për një përshkrim të detajuar të ngjarjeve tragjike, të humbjeve në njerëz, për dëmet materiale si dhe shkatërrimet e të mirave kulturore të komunitetit serb dhe të komuniteteve tjera joshqiptare të Kosovës, Cf. më shumë në "Failure to Protect: Anti-Minority Violence in Kosovo, March 2004". *HUMAN RIGHTS WATCH* Vol. 16 No. 6 (July 2004). Në internet: https://www.hr.org/report/2004/07/25/failure-protect/anti-minority-violence-kosovo-march-2004#page (shikuar në mars 2022).

159 Për detajet e bisedimeve, kohën e zgjatjes së tyre dhe gjendjen e brendshme të palëve dhe të vetë përfaqësuesit special **Marti Ahtisari** dhe ekipit të tij, cf. më shumë në: Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar. Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi* (në kapitullin 12 autori diskuton detajet, si pjesëmarrës në negociata të **Vjenës** dhe në negociatat tjera shtesë, vështirësitë dhe obstruksuionin serb, kurse në kapitullin 13 autori analizon tekstin e **Planit Ahtisari** nga aspekti politiko- kushtetues dhe juridiko- ndërkombëtar; në kapitullin 14 autori paraqet detaje nga procesi i kushtetutëbërjes në **Kosovë,** gjithnjë në suazat e propozimeve të **Planit Ahtisari** dhe skicës juridiko – kushtetuese të draftuar nga ai, sikundër dhe për rolin e bashkësisë ndërkombëtare dhe ekspertëve vendorë, ka rëndësi të madhe sepse në mënyrë të drejtpërdrejtë ka të bëjë me procesin e draftimit të Kushtetutës së Kosovës sipas rekomandimeve të kuadrit juridik të skicuar në Planin Ahtisari); James Ker-Lindsay, *Kosovo: The Path to Contested Statehood in the Balkans* (I.B.Tauris & Co. Ltd.: London, 2009) (autori në kapitujt 2 dhe 3, nga një këndvështrim tërësisht pro-serb dhe por-rus flet për bisedimet e drejtpërdrejta në **Vjenë** dhe gjetiu me ndërmjetësimin e përfaqësuesit special **Marti Ahtisari** si dhe për propozimet konkrete dhe arsyet e serbëve për mospranim të **Planit Ahtisari**).

160 **Plani Ahtisari** përbëhej prej pjesës kuadër apo pjesës së përgjithshme dhe 12 (dymbëdhjetë ankesave) të kësaj pjesë.

161 Në pikën 11 nën "e" të Rezolutës 1244 qartë thuhet se statusi i ardhshëm i Kosovës do të caktohej përmes një procesi politik.

162 Cf. Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar. Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*, fq. 386-390.

163 Neni 5 ["Shkurtimi dhe përfundimi i mandatit të Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar"] i Aneksit IX ["Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar"] të **Planit Ahtisari**:
"5.1 Bazuar në rekomandimet e **PCN**-së, **Grupi Drejtues Ndërkombëtar** do t'i përcaktojë standardet për shqyrtimin periodik të mandatit të **PCN**-së dhe do ta zhvillojë një shqyrtim të plotë të kompetencave të PCN-së jo më vonë se dy vjet pas hyrjes së fuqi të kësaj marrëveshjeje, duke synuar ngushtimin gradual të fushëveprimit të kompetencave të **PCN**-së dhe shpeshtësisë së intervenimeve të tij/saj.

më me rëndësi të Planit janë ato të aneksit I ["Dispozitat Kushtetuese"], si dhe ato që garantonin supremacinë (epërsinë) e tij gjatë tërë kohës së pavarësisë së mbikëqyrur.[164]

Në rast mosmarrëveshje lidhur me kuptimin dhe caqet e zbatimit të tij, interpretimi binte në kompetencë ekskluzive të autoriteteve ndërkombëtare, të cilat kanë qenë të autorizuara për të mbikëqyrur pavarësinë e Kosovës.[165]

Edhe **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**, miratuar më 9 prill 2008, përsërit të njëjtat zotime për supremacinë (epërsinë) e dispozitave të Planit. Për më tepër, ajo flet edhe për supremacinë (epërsinë) e dispozitave të rregulloreve dhe akteve të tjera të **UNMIK**-ut deri në nxjerrjen e ligjeve dhe akteve kosovare që do të rregullonin materien e njëjtë që deri në pavarësi ato e kishin rregulluar.[166] Këto dispozita për supremacinë (epërsinë) e përkohshme të rregulloreve dhe akteve të tjera të **UNMIK**-ut ishte futur në Kushtetutën e **Kosovës** si pasojë e zotimit të njëanshëm të Kosovës për të respektuar **Rezolutën 1244**. Në këto zotime hyjnë edhe zotimet tjera ndërkombëtare që ishin marrë nga **UNMIK**-u në emër dhe për llogari të Kosovës gjatë kohës së administrimit të tij në vend (10 qershor 1999-17 shkurt 2008).[167] Kosova e kishte dhënë këtë zotim në mënyrë të qartë në **Deklaratën e Pavarësisë** të datës 17 shkurt 2008. Në të drejtën ndërkombëtare, çdo deklaratë për shpalljen e pavarësisë paraqet një akt të njëanshëm që krijon detyrime **erga omnes** në të cilat mund të thirret çdo kush në bashkësinë ndërkombëtare, secili shtet apo secila organizatë ndërkombëtare.[168]

5.2 Mandati i **PCN**-së do të skadojë atëherë kur Grupi Drejtues Ndërkombëtar të konstatojë se Kosova i ka përmbushur kushtet e kësaj marrëveshjeje".

164 Në nenin 1 ["Dispozitat Themelore"] të Aneksit I ["Dispozitat Themelore"] të **Planit Ahtisari** përcaktohej se **Kushtetuta e Kosovës:**
" 1.1 Do të jetë në të gjitha dispozitat e saj në pajtim me këtë Marrëveshje dhe do të interpretohet në pajtim me këtë Marrëveshje; në rast të mospërputhjeve mes dispozitave të kushtetutës dhe dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, do të mbizotërojnë këto të fundit […]".

165 Neni 11 ["Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar"] i pjesës kuadër apo të përgjithshme të **Planit Ahtisari:**
"[…] 11.3 **PCN** do të ketë përgjegjësi të përgjithshme për mbikëqyrjen, dhe do të jetë autoriteti përfundimtar në **Kosovë** për sa i përket interpretimit të kësaj Marrëveshjeje, siç parashihet me Aneksin IX, e veçanërisht nenin 2, të kësaj Marrëveshjeje […]".

166 Neni 145. 2 ["Vazhdimësia e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe e Legjislacionit të Aplikueshëm"] i Kushtetutës:
"[…] 2. Legjislacioni i aplikueshëm në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute vazhdon të zbatohet për aq sa të jetë në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë, derisa të mos shfuqizohet, zëvendësohet ose amendamentohet në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë".

167 Paragrafi 9 i **Deklaratës së Pavarësisë**:
"[…] 9. Ne, nëpërmjet kësaj Deklarate, marrim obligimet ndërkombëtare të Kosovës, përfshirë ato të arritura në emrin tonë nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), si dhe obligimet e traktateve dhe obligimet tjera të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ndaj të cilave obligohemi si ish-pjesë konstituive, përfshirë konventat e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike dhe konsullore. Ne do të bashkëpunojmë plotësisht me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. Ne synojmë të kërkojmë anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, në të cilat Kosova do të synojë të kontribuojë për qëllime të paqes dhe stabilitetit ndërkombëtar".

168 Paragrafi i fundit i **Deklaratës së Pavarësisë** pa dykuptimësi ngërthen këtë zotim të njëanshëm të Kosovës, kur thotë si vijon:
"[…] 12. Ne, nëpërmjet kësaj, afirmojmë në mënyrë të qartë, specifike dhe të parevokueshme se Kosova do të jetë ligjërisht e obliguar të plotësojë dispozitat e përmbajtura në këtë Deklaratë, përshirë këtu veçanërisht obligimet e saj nga Plani i Ahtisaarit. Në të gjitha këto çështje, ne do të veprojmë në pajtueshmëri në parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, përfshirë Rezolutën 1244 (1999). Ne shpallim publikisht se të gjitha shtetet kanë të drejtën të mbështeten në këtë Deklaratë, dhe i bëjmë apel të na ofrojnë përkrahjen dhe mbështetjen e tyre". Për pikëpamje të ngjashme apo të njëjtë me këtë, cf. më shumë në Colin Warbrick, "Kosovo: The Declaration of Independence " *International and Comparative Law Quarterly*. Volume 57 Issue 03 (July 2008) fq. 675 – 690, në fq. 679 & 684; Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar. Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*, fq. 377.

Sikundër u tha në fillim të këtij seksioni, **Maqedonia e Veriut, Mali i Zi** dhe **Serbia** hyjnë në radhë për diskutim vetëm sa i përket historisë së tyre kushtetuese pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe fitimit të pavarësisë së tyre. Kjo për faktin se pozita e shqiptarëve në këto republika, gjatë kohës së ekzistimit të ish-Jugosllavisë, ka qenë e përcaktuar nga **kushtetutat federale** dhe **pushteti qendror federal** (1946-1974), në ndërkohë që gjatë kohës së Mbretërisë SKS/Jugosllave as që bëhet fjalë për ndonjë konstitucionalizëm dhe identitet kushtetues të shqiptarëve dhe pakicave të tjera kombëtare.

Zhvillimi kushtetues në **Maqedoninë e Veriut** ka kaluar nëpër disa faza.[169] Faza e parë nis me vitin 1880 e deri në gjysmën e parë të shekullit XX.[170] Faza e dytë përfshinë periudhën e gjysmës së dytë të shekullit në fjalë dhe përshinë aktet e konstituimit të këtij vendi si shtet sovran dhe i pavarur dhe ridefinimet e mëpastajme të identitetit kushtetues që kanë të bëjnë me **Marrëveshjen e Ohrit** (2001)[171] dhe **Marrëveshjen e Prespës** (2018).[172]

Sikundër u tha, historia kushtetuese e **Maqedonisë së Veriut**, nga konstitucionalistët e këtij vendi nis me **Kushtetutën e Tërnovës**, miratuar më 16 prill 1789 nga një kuvend kushtetues kryengritës, si pjesë e themelimit të **Principatës së Bullgarisë**. Kryeqytet i saj ka qenë i përcaktuar Sleaniku, si dhe selia e **Kishës Ortodokse Bullgare**. Kushtetuta ka pasur pjesën hyrëse (preambulën) dhe pjesën operative. Kjo e fundit ka pasur gjithsejtë 103 nene dhe 13 pjesë. Ka qenë një kushtetutë liberale për kohën dhe ka sanksionuar një shtet multietnik, aq sa në literaturën maqedonase e kanë krahasuar me **Marrëveshjen e Ohrit**,[173] me ndarje e balancim të pushteteve, me një princ si shef i një principate autonome, të trashëgueshme dhe vasale. Përveç shefit të shtetit, Kushtetuta ka përcaktuar edhe këto organe shtetërore: Parlamentin, Këshillin e Shtetit dhe Këshillin e Ministrave. Me të përcaktohej edhe një sistem gjyqësor në të gjitha nivelet. Kushtetuta ka qenë në fuqi deri në vitin 1947, kur u miratua **Kushtetuta e Dimitrovit** (liderit komunist bullgar).[174] Edhe pas ngritjes në mbretëri në vitin 1908, Kushtetuta ngeli në fuqi, kurse ndryshime pësoi më 1893 dhe 1911. Si specifikë e kësaj ka qenë që ka përcaktuar kufijtë e Bullgarisë, pra i ka cilësuar kufijtë si **materia constitutionis**, jo si **materia legis**.[175]

Varianti komunist i kuvendit kushtetues gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore, i njohur si **ASNOM** (Антифашистичко собрание за народно ослободување на Македонија; shqip: Kuvendi Antifashist për Çlirimin Nacional të Maqedonisë), është mbajtur në manastirin **Prohor Pcinjski**, që sot gjendet në jug të qytetit Vranje në jug të Serbisë. I mbajtur me 2 e 3 gusht 1944, Kuvendi konsid-

169 Këtë ndarje e bazojmë në tekstin më me ndikim të së drejtës kushtetuese në këtë vend, të autorit Svetomir Škarič, *Ustavno pravo*. 8 izdanje (Kultura: Skopje, 2015) (në gjuhën maqedono-veriore, alfabetin cirilik), fq.314-317; 340-341; 342-346.

170 Kjo fazë, sikundër do të shihet, në të vërtetë ka të bëjë me zhvillimin kushteteus të **Bullgarisë**, mirëpo në Maqedoninë e Veriut merret si pjesë e konstitutcionalizmit të tyre (sic!).

171 Për këtë dokument me rëndësi kushtetuese flasim në seksionin 4.3.3., **infra,** (në pjesën që ka të bëj me burimet e të drejtës kushtetuese në këtë vend).

172 Për tekstin e plotë të Marrëveshjes, cf. **Final agreement for the settlement of the differences as described in United Nations Security Council resolutions 817 (1993) and 845 (1993), the termination of the Interim Accord of 1995, and the establishment of a strategic partnership between the Parties**. Në internet: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/viewer.html?pdfurl=https%3A%2F%2Fs.Kathimerini.gr%2Fresources%2Farticle-files%2Fsymfwnia-aggliko-keimeno.pdf%23Question&clen= 7300723 & chunk=true (shikuar në mars 2022).

173 Svetomir Škarič, *Ustavno pravo*, fq. 316.

174 Gjatë kryengritjes së **Ilindenit** (gusht-tetor 1903), u shpall **Republika e Krushevës**, kundër **Perandorisë Otomane**, e cila gjithashtu në historiografinë bullgare dhe botërore konsiderohet si produkt i pastër bullgar dhe jo sllavo-maqedon. Edhe këtë moment në historinë e përbashkët, sllavo-maqedonët në **Maqedoninë e Veriut** e kanë përvetësuar si të tyrin, duke e reflektuar në preambulën e Kushtetutës aktuale të **Maqedonisë së Veriut**, pas pavarësimit të saj nga **ish-Jugosllavia**, për të cilën flasim në vijim. Preambula në këtë aspekt nuk ka pësuar ndryshim as më vonë, më 2001, pas amendamentimeve që pasuan pas konfliktit në mes të shqiptarëve dhe forcave sllavo-maqedone të rendit dhe sigurisë.
Është shumë e qartë, megjithatë, se në fillim të shekullit XX, liderët politik dhe ushtarak të sllavëve të Maqedonisë së Veriut nuk kishin dëgjuar për identitetin e ndarë nacional maqedon. Ata kanë vazhduar të identifikojnë veten e tyre në aspektin kombëtar me bullgarët, jo maqedonët. Asnjëherë nuk duket se kanë dyshuar që karakteri mbizotërues I sllavëve të maqedonisë ka qenë bullgar. Cf. më shumë në Loring Danforth, *The Macedonian Conflict: Ethnic Nationalism in a Transnational World* (Princeton University Press: Princeton, 1997), fq. 64.

175 Ibid., fq. 315.

erohet si gurthemel i shtetësisë së Maqedonisë së Veriut, njohje e të drejtës së saj për vetëvendosje dhe barazi me popujt jugosllavë. Është mbajtur në vijim të zbatimit të vendimit të KAÇKJ-së të vitit 1943, dhe ka formatin e njëjtë: ASNOM-i konstituohet si organ kryesor politik dhe ekzekutiv i pushtetit dhe Republika e Maqedonisë formohet në baza socialiste si njësi federale e ish-Jugosllavisë jokomuniste, shtet me karakter unitar i kombit maqedon dhe i pakicave kombëtare që jetojnë në të.[176]

Tri janë aktet që konstituojnë **Maqedoninë e Veriut** si shtet sovran dhe i pavarur. I pari është **Deklarata e Pavarësisë** e datës 8 shtator 1991, me të cilin shprehet dëshira e qytetarëve të këtij vendi për të qenë shtet sovran dhe i pavarur përmes shprehjes së vullnetit të tyre me referendum. I dyti është akti i referendumit, mbajtur më 17 shtator 1991, me të cilin vërtetohet dëshira e Deklaratës së Pavarësisë nga janari i vitit 1991. Deklarata ka preambulën dhe pjesën normative. Në pjesën e preambulës jepen dy baza juridike për nxjerrjen e saj: baza e parë, **Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë Socialiste** e vitit 1974, që i njihte të drejtën **Kuvendit të Maqedonisë Socialiste** për miratimin e deklaratave si akte politike dhe, baza e dytë, Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike (1966), që ua njeh popujve të drejtën për vetëvendosje. Në pjesët deklarative të preambulës hyjnë: dispozitat mbi sovranitetin, pavarësinë dhe integritetin territorial të vendit, të drejtën për vetëvendosje deri në shkëputje, sistemin politik, ekonomik dhe juridik të vendit etj. Dispozitat normative konsistojnë në zbatimin e përkohshëm të dispozitave të vjetra që nuk bien ndesh me të rejat, rregullimin e marrëdhënieve me vendet dhe popujt të tjerë të ish-Jugosllavisë, qytetarët maqedonë dhe statusin e tyre, mbrojtja e sllavëve maqedonë jashtë kufirit shtetëror dhe kështu me radhë. **Referendumi** nuk ka pasur karakter konstituiv, por konsultativ, që do të thotë se konstituimi i Maqedonisë së Veriut si shtet sovran dhe i pavarur ka ndodhur më herët kurse vërtetimi i rezultateve të referendumit vetëm ka konstatuar një gjë të tillë, përkatësisht se miratimi i **Deklaratës së Pavarësisë** më 8 shtator 1991 shënon ditën e krijimit të këtij vendi si shtet sovran dhe i pavarur.[177]

Pas konstituimit si shtet, **Maqedonia e Veriut** ka pasur probleme serioze me identitetin e saj kushtetues dhe ndërkombëtar, sa i përket **flamurit** të saj shtetëror, **emrit** dhe dispozitave kushtetuese që flisnin për pretendimet territoriale ndaj vendeve fqinje. Problemi i fundit është adresuar shumë herët ashtu që janë mënjanuar nga Kushtetuta dispozitat kontestuese që asoconin në pretendime territoriale ndaj vendeve fqinje dhe përzierje në punët e tyre të brendshme.[178] Çështja e flamurit është zgjidhur më vonë, në vitin 1995,[179] kurse ajo e emërimit vetëm më 2019 me **Marrëveshjen e Prespës**. Deri atëherë, me insistimin e **Greqisë**,

---

176 Cf. më shumë në Loring Danforth, *The Macedonian Conflict: Ethnic Nationalism in a Transnational World* (Princeton University Press: Princeton, 1997), fq. 326.

177 Cf. më shumë në Loring Danforth, *The Macedonian Conflict: Ethnic Nationalism in a Transnational World* (Princeton University Press: Princeton, 1997), fq. 342-346.

178 Cf. **VENDIM PËR SHPALLJEN E AMENDAMENTEVE I DHE II TË KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË.** Shpallen Amendamentet I dhe II të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, të cilat i miratoi Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, në seancën e mbajtur më 6 janar 1992.

179 Flamuri aktual i **Republikës së Maqedonisë së Veriut** përmabnë një yll të verdhë të stilizuar në një fushë të kuqe, me tetë rreze të zgjeruara që shtrihen nga qendra në skajlin e fushës ku shtrihet ylli. Është krijuar nga artisti maqedono-verior **Mirosalv Gërqev** (Miroslav Grčev) dhe është miratuar nga **Kuvendi i Maqedonisë së Veriut** më 5 tetor 1995. Dielli me tëtë rreze përfaqëson "dritën e lirë të Lirisë", që i referohet himnit nacional të Maqedonisë së Veriut. Flamuri i parë i vendit, rreth të cilit pat lindur kontesti me grekët, njihet si **Flamuri Vergina**, që paraqet **Diellin e Verginas**, një symbol që është zbuluar në qytetin grek **Aigai**, kryeqyteti i parë dhe vendi i varrimit të mbretërve të vjetër të Maqedonit dhe symbol i dinastisë **Argead** të **Filipit II të Maqedonit** (Philip II of Macedon: 382-336) dhe djalit të tij Aleksandrit të Madh (Alexander III of Macedon: 356-323).
Flamuri i parë i **Maqedonisë së Veriut** nuk ka mund të valoj në ndërtesën e KB dhe institutcionet tjera ndërkombëtare. Në korrik të vitit 1995, **Greqia** pat aplikuar për mbrojtjen e shenjës dalluese të **Diellit Vergina**. Bllokada ekonomike dhe tjetër ndaj Maqedonisë së Veriut u pezullua në tetor të vitit 1995, pas arritjes së një marrëveshje në mes të palëve për ndryshim të flamurit dhe modifikim të Kushtetutës. Cf. më shumë në Michael C. Wood, "Participation of Former Yugoslav States in teh United Nations and Multilateral Treaties". *Max Planck Yearbook of United Nations Law* Vol. 1 (1997), fq. 231-257.

ky vend ndërkombëtarisht ka qenë i njohur si "Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë/**IRJM**".[180] Paralel me problemet me Greqinë, **Maqedonia e Veriut** ka pasur ngatërresa serioze me shqiptarët autoktonë, të cilëve për një kohë të gjatë ua mohonte të drejtat themelore të njeriut, ani se të gjitha kushtetutat e saj proklamonin barazinë në mes të popujve. Në fakt, vetë **Kuvendi i ASNOM**-it, që prodhoi grundnormën e këtij vendi, ka përcaktuar se shteti i ri do të ndërtohej si njësi federale e kombeve dhe pakicave kombëtare të barabarta. Për këtë arsye, në këtë vend ka pasur një konflikt të armatosur në mes të shqiptarëve, të udhëhequr nga **Ushtria Çlirimtare Kombëtare***,* gjithashtu e njohur me akronimin e saj "UÇK", dhe forcave sllavo-maqedone të rendit dhe sigurisë, me qëllim të realizimit të barazisë reale kushtetuese në mes të popullit shqiptar dhe popullit sllavo-maqedon. Vetë liderët e **Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare** pandërprerë proklamonin se lufta e tyre nuk ishte për ta prishur Maqedoninë e Veriut, por për barazi. Kjo luftë çoi në arritjen e **Marrëveshjes së Ohrit** më 13 gusht 2001 (nënshkrimi është bërë në Shkup). Me këtë Marrëveshje nuk ndryshuan bazat e **grundnormës** së **Maqedonisë së Veriut**, sepse shqiptarët vetëm fituan disa nga të drejtat që u takojnë pakicave kombëtare, kryesisht të natyrës politike dhe kulturore, në rend të parë të drejtat për të qenë të përfaqësuar në të gjitha nivelet e autoritetit publik dhe për të shprehur, ruajtur dhe kultivuar identitetin e tyre nacional. Esenca e saj ka pasur të bëjë me sigurimin e të drejtave kolektive të shqiptarëve, përkatësisht me ndryshimin e natyrës civile të definimit të shtetësisë së Maqedonisë së Veriut, që në fakt garantonte hegjemoninë e sllavo-maqedonëve kundër shqiptarëve që përbëjnë një shumicë substanciale në këtë vend. Për këtë arsye, vetë termi kombësi ("nacionalnost") u zëvendësua me një term tjetër kushtetues, "komunitet" (nacional, fetar dhe tjetër). [181] Ndryshimi i preambulës në vitin 2001 reflekton këtë, me Amendamentin IV, ka sforcuar edhe më shumë idenë se vendimet e **ASNOM**-it dhe Republikën e Krushevës janë themele të grundnormës së Maqedonisë së Veriut.[182]

Në rastin e shtjellimeve të konstitucionalizmit në **Mal të Zi**, si libër bazë është marrë libri mbi të drejtën kushtetuese i autorit **Mijat Shukoviq** (Mijat Šuković: 1930 – 2011),[183] por edhe disa autorë të tjerë që kanë shkruar lidhur me këtë çështje. **M. Shukoviq**, por edhe të tjerët, zhvillimin e konstitucionalizmin malazez e lidhin fort për kodet e ligjet, si dhe normat tjera të kohës së organizimit fisnor të vendit nën pushtimin otoman. Në këtë kategori fusin aktet juridike si vijon: aktin e parë juridik me emrin "Stega" (1776), që do të thotë "Freri"; Kodin e përgjithshëm malazez dhe të maleve (1798 dhe 1803), të cilit si shtojcë në vitin 1803 i bashkëngjitet "Stega"; vendimi mbi themelimin e principatës së **Malit të Zi** (1852), me të cilën vjen deri te ndarja e pushtetit fetar nga pushteti civil; Kodi i përgjithshëm i vendit (1855); aktet e reformës pas fitimit të pavarësisë së plotë në vitin 1878, të nxjerra në periudhën në mes të viteve 1879-1902; dhe Kodi i përgjithshëm pasuror (1888). Të gjitha këto akte juridike, sipas autorëve malazezë, ngërthejnë dispozita kushtetuese mbi origjinën, organizimin dhe ushtrimin e pushtetit shtetëror, një pjesë bukur e madhe e dispozitave të të cilave kanë karakter të së drejtës zakonore. Gjithnjë sipas këtyre autorëve, kjo nënkupton se këtu bëhet fjalë për kushtetutë materiale malazeze.[184] Kushtetuta e parë formale, pra kushtetuta e parë që në formë të shkruar kodifikon në mënyrë gjithëpërfshirëse marrëdhëniet kryesore shoqërore në vend-

[180] Përdorimi emerit "Maqedonia" është kontestuar paralel me dy çështjet tjera nga ana e Greqisë. Ky kontestim ka zgjatur nga viti 1991 deri në vitin 2019. Në ndërkohë është përdorur, në planin ndërkombëtar, emri **IRJM**. Kjo çështje ka qenë një burim potencial jostabiliteti në rajon, deri në arritjen e **Marrëveshjen e Prespës**, me ndërmjetësimin e **Kombeve të Bashkuara**, më 17 qershor 2018, që u ratifikua në fund të atij viti nga dy parlamentet nacionale në Shkup dhe Athinë (IRJM u emrua zyrtarisht Maqedonia e Veriut në shkurt të vitit 2019). Kontesti ka lindur nga dykuptimësia e nomenklaturës në mes të Republikës së Maqedonisë dhe regjinionit grek me emrin Maqedonia dhe mbretërisë së lashtë greke të Maqedoni.

[181] Cf. më shumë në Tanja Karakamiševa, "Human Rights in the Republic of Macedonia Seen Through the Lens of the Constitution and the Practice of Democracy". ***Revus.*** *Journal for Constitutional Theory and Philosophy of Law/Revija za ustavno teorijo in filozofijo prava*. Vol. 11 (2009), fq. 151-166 në fq. 156-159.

[182] **VENDIM PËR SHPALLJEN E AMENDAMENTEVE IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII, XIII, XIV, XV, XVI, XVII dhe XVIII TË KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË.** Shpallen amendamentet IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII, XIII, XIV, XV, XVI, XVII dhe XVIII të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë të cilat i miratoi Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, në seancën e mbajtur më 16 nëntor 2001.

[183] Mijat Šuković, *Ustavno pravo* (CID: Podgorica, 2009).

[184] Mijat Šuković, *Ustavno pravo*, fq. 77-122; Mladen Vukčević, *Komentar Ustava Crne Gore* (Univerzitet MEDITERAN: Podgorica, 2015),17-20.

marrëdhëniet kushtetuese – ka lindur më 19 shtator 1905, kur princi malazez **Nikola I Petroviq Njegosh** (Nikola I Petrović-Njegoš: 1841-1921), ua dhuroi malazezëve kushtetutën e parë, sipas modelit të kartave kushtetuese të një shekulli më herët.[185] Nga kjo mund të vërehet qartë se **grundnormën** e Malit të Zi duhet kërkuar në vendimin për themelimin e **Principatës së Malit të Zi**, përkatësisht në vendimin e datës 13 mars 1852, kur princi **Danilo I Petroviq Njegosh** (Danilo I Petrović-Njegoš: 1826-1860) shpalli ndarjen e pushtetit fetar nga pushteti civil. Principata ka zgjatur deri më 28 gusht 1910 kur princi **Nikola I Petroviq Njegosh shpalli Mbretërinë e Malit të Zi** dhe vetë u bë mbret i saj i parë.[186]

Zyrtarisht, **Mbretëria e Malit të Zi** ka qenë monarki kushtetuese, por në praktikë një monarki absolutiste. Më 28 nëntor 1918, pas mbarimit të **Luftës së Parë Botërore**, me qeverinë e vendit akoma në mërgim, një kuvend jolegal dhe jolegjitim, i njohur si **Kuvendi i Podgoricës**, shpalli shkrirjen e Monarkisë me **Mbretërinë SKS** që u formua tri ditë më vonë, më 1 dhjetor 1918.[187] Ky unifikim i dhunshëm ka zgjatur, në forma të ndryshme të organizimit politik, për tetëdhjetetetë vjet, për të marr fund në vitin 2006. Në nëntor të vitit 1943 u vunë themelet e shtetësisë moderne malazeze, kur vendi u shpall njëra ndër njësitë federale e ish-Jugosllavisë komuniste që do të ndërtohej pas Luftës së Dytë Botërore. E kemi fjalën për vendimet tanimë të diskutuara të mbledhjes së **KAÇKJ-së**. Në mes të dy luftërave botërore, njëjtë sikur shqiptarët, maqedonët dhe popujt e tjerë, as malazezët nuk kanë pasur identitet të pranuar kushtetues, përfshirë identitetin etnik dhe tjetër të malazezëve, që kurrë nuk qe pranuar nga autoritetet serbe të Mbretërisë SKS/Jugosllave: malazezët kanë qenë të shtypur pa asnjë mëshirë, duke i konsideruar si serbë etnikë, apo si një variant i kombit serb. Mbledhja e **KAÇKJ-së** ishte e njëjtë si për maqedonët sllavë, pra si një prelud që vuri themelet për krijimin e Malit të Zi si njësi federale. Për malazezët kjo nënkuptonte vënie e themeleve për restaurimin e shtetësisë së humbur në vigjilje të krijimit të Mbretërisë SKS.[188] Si njësi federale e ish-Jugosllavsië komuniste, **Mali i Zi** ka ekzistuar deri në pranverë të vitit 1992, kur u nxor **Kushtetuta e Zhablakut** (27 prill 1992). Nga kjo kohë, pra nga shpërbërja e Jugosllavisë komuniste e deri te krijimi i **Malit të Zi** si shtet sovran dhe i pavarur, me subjektivitet të plotë ndërkombëtar, ekzistojnë tri faza. Faza e parë është rregullimi kushtetues i këtij vendi në kuadër të **Federatës së Jugosllavisë** ("RFJ"), e përbërë nga **Serbia dhe Mali i Zi** (1992-2002), që u krijua nga diktatori serb **S. Millosheviq.** Faza e dytë është rregullimi jo i zakonshëm kushtetues, që njihet me emrin si **Bashkësia Shtetërore Serbi – Mali i Zi** (2002- 2006). Dhe, së fundi, faza e tretë, përfshinë rregullimin kushtetues si shtet sovran dhe i pavarur me subjektivitet të plotë ndërkombëtar (nga maji 2006).[189]

Në rastin e formimit të **RFJ-së** (Serbi dhe Mali i Zi), që për ligj më të lartë pati **Kushtetutën e Zhablakut**, si **grundnormë** ka shërbyer një dokument i titulluar si "Bazat e rregullimit dhe funksionimit të Jugosllavisë si shtet i përbashkët". Mbi bazën e këtij dokumenti është nxjerr pastaj **Kushtetuta e Zhablakut**. Ky dokument në tërësi ka qenë antikushtetues, sepse nuk ka respektuar asnjë dispozitë kushtetuese procedurale të Kushtetutës së ish-RSFJ-së të vitit 1974 për rishikim kushtetues, që ka qenë në fuqi në atë kohë.[190] As në planin e jashtëm asnjëherë nuk është njohur si shtet trashëgimtar i ish-Jugosllavisë së formuar më 1 dhjetor 1918, por ekskluzivisht si njëri prej pesë shteteve të reja të dala nga rrënojat e saj,

185 Mijat Šuković, *Ustavno pravo*, fq.125-148; Mladen Vukčević, *Komentar Ustava Crne Gore*, fq. 21-22.

186 Deri në vitin 1852, në **Mal të Zi** ka ekzistuar një lloj i shtetit-kishë, përkatësisht një organizim kishtar politik, qysh nga viti 1515, kur Mali i Zi u shpall shtet teokratik që udhëhiqej nga Metropoliti i Malit të Zi dhe Bregdetit. Ky entitet kishtar politik lulëzoi gjatë kohës së Petrovic Njegoshit (Petrović-Njegoš:) të Cetinjës, i cili mbante titullin e "Vladika i Malit të Zi" (titull kishtar për sundimtarin që njëkohësisht është sundimtar dhe kryepeshkop. Prandaj kjo kohë nuk llogaritet si shtetësi e Malit të Zi në kuptimin bashkëkohor të fjalës, sepse nuk ka qenë shtet por organizim kishtar politik).

187 Mijat Šuković, *Ustavno pravo*, 148-154; Mladen Vukčević, *Komentar Ustava Crne Gore*, fq. 24-25.

188 Diskursi i konstitutcionalistëve malazez, pa përjashtim, ka konsensus se mbledhja e **KAÇKJ**, si dhe tubimi i ngjashëm në nivel të **Malit të Zi**, i njohur si **ZAVNOCGB (**"Zemaljsko antifašističko vijeće narodnog oslobođenja Crne Gore i Boke"), mbajtur më 15 dhe 16 nëntor 1943, ka qenë gurthemel i restaurimit të shtetësisë së humbur me **Kuvendin e Podgoricës**. Cf. Mijat Šuković, *Ustavno pravo*, fq. 156-158; Mladen Vukčević, *Komentar Ustava Crne Gore*, fq. 24-25.

189 Mijat Šuković, "Tri različita ustavna uređenja Crne Gore", ***Revus.*** *Journal for Constitutional Theory and Philosophy of Law /Revija za ustavno teorijo in filozofijo prava*. Vol. 11 (2009), fq. 9-43.

190 Mladen Vukčević, *Komentar Ustava Crne Gore*, fq. 27.

tani me emrin e ri **RFJ** (Serbi dhe Mali i Zi).[191] Secila prej republikave kanë miratuar më pas kushtetutat e tyre, që formalisht kanë proklamuar parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe një kartë të pasur të lirive dhe të drejtave të njeriut. RFJ-ja, megjithatë, ka qenë një autokraci në duart e diktatorit serb Sllobodan Millosheviq deri në përmbysjen e tij nga pushteti, në vjeshtë të vitit 2000.

Me qëllim që të ridefinohen marrëdhëniet në mes të Serbisë dhe Malit të Zi, sërish është provuar të ridizajnohet sistemi kushteues i RFJ-së, këtë herë me ndërmjetësimin e fuqishëm të bashkësisë ndërkombëtare. Kjo përpjekje ka rezultuar në arritjen e asaj që njihet si **Bazat fillestare të rirregullimit të marrëdhënieve në mes të Serbisë dhe Malit të Zi** (e nënshkruar në mes të Serbisë dhe Malit të Zi më 14 mars 2002 në Beograd), me të cilën u themelua **Bashkësia Shtetërore Serbi – Mali i Zi**. Më pastaj, më 4 shkurt 2003 u miratua **Karta Kushtetuese e Bashkësisë Shtetërore Serbi-Mali i Zi**. Një kartë mbi të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve e të qytetarit u miratua më 28 shkurt 2003. Rregullimi shtetëror me këtë rast ka qenë konfederal në të gjitha dimensionet, përveç statusit ndërkombëtar që akoma nuk e kanë pasur të plotë dy shtetet përbërëse të kësaj bashkësie. Ky status do të rregullohet në vitin 2006, pas shpalljes së pavarësisë së plotë të **Malit të Zi** dhe bërjes së tij shtet sovran me të drejta të barabarta si anëtar i bashkësisë ndërkombëtare. Kjo ka ndodhur me 3 qershor 2006, kur Mali i Zi mori vendimin për shpalljen e pavarësisë së **Malit të Zi** dhe miratoi Deklaratën e Malit të Zi të Pavarur. Këto vendime ky vend i ka marr në bazë të vendimit të referendumit për pavarësi të mbajtur më 21 maj 2006, me të cilën qytetarët u deklaruan pro pavarësisë së plotë të Malit të Zi. Referendumi është mbajtur nën mbikëqyrjen e BE-së, bazuar në nenin 60 të Kartës Kushtetuese që lejonte shkëputjen e secilit prej dy anëtarëve të Bashkësisë Shtetërore. Si ditë e sovranitetit malazez, ndërkaq, konsiderohet 13 korriku, dita kur më 1878 **Kongresi i Berlinit** ka njohur pavarësinë e Malit të Zi.

Vendimi mbi shpalljen e pavarësisë së Malit të Zi i datës 3 qershor 2006 ka karakter konstituiv. Me të Kuvendi i Malit të Zi ka shprehur vullnetin e vet për vënien në jetë të rezultateve të **referendumit** të datës 21 maj të atij viti. Me këtë vendim pranohen detyrimet juridike-ndërkombëtare për aq sa ato kanë të bëjnë me Malin e Zi, kontinuitetin e rendit juridik, u mor vesh, për aq sa ai rend nuk bie ndesh me normat aktuale kushtetuese. Në fund konstatohet rifitimi i subjektivitetit të plotë shtetëror juridik-ndërkombëtar të Malit të Zi dhe kështu me radhë. Sa i përket Deklaratës, ndërkaq, ajo ka natyrën e tekstit **urbi et orbi**, që drejtohet parasëgjithash ndaj organizatave ndërkombëtare (universale e regjionale). Në një lloj preambule, ajo ripërsëritë burimet historike dhe traditën malazeze të shtetësisë së humbur dhe subjektivitetin e saj ndërkombëtar të fituar në shekullin XIX, duke shprehur gatishmërinë e vendit për të respektuar parimet themelore të së drejtës ndërkombëtare dhe duke treguar substratin me vlerë juridike, politike dhe tjetër mbi të cilin qëndron shteti i rikrijuar malazez.[192] Sipas të drejtës ndërkombëtare, megjithatë, as **Mali i Zi** e as **Serbia** pas 21 majit 2006 (kur u pavarësua Mali i Zi) nuk janë rikrijuar mbi bazat e shtetësisë së vjetër që kanë pasur para 1 dhjetorit 1918, por si shtete tërësisht të reja të dala nga rrënojat e ish-Jugosllavisë. Dy këto shtete, pra, nuk kanë qenë kontinuitet i ish-Jugosllavisë dhe as i mbretërive malazeze dhe serbe që kanë ekzistuar para 1 dhjetorit 1918. Thënë me fjalë të tjera, **grundnorma** e Malit të Zi sot nuk qëndron në shek. XIX, në vitin 1852, por ankorohet në aspektin kohor në datën 21 maj 2006, ditë kur u pavarësua Mali i Zi dhe, për pasojë, edhe Serbia me automatizëm u shndërrua në shtet sovran dhe të pavarur, me subjektivitet të plotë ndërkombëtar.

Kështu, u mor vesh, nuk mendojnë konstitucionalistët serbë. Autori kryesor i të drejtës kushtetuese në Serbi, **Ratko Markoviq** (Ratko Marković: 1944-2021), konstitucionalisti më me ndikim i viteve '90-të të shekullit të kaluar, për arsye krejtësisht të tjera, beson se, **Serbia** jo vetëm që është trashëgimtare e vetme e RFJ-së (1992), por edhe e ish-Jugosllavisë së themeluar më 1 dhjetor 1992 dhe e shpërbërë në

[191] Cf. më shumë në Enver Hasani, "Self-Determination under the Terms of the 2002 Union Agreement between Serbia and Montenegro: Tracing the Origins of Kosovo's between Serbia and Montenegro". *Chicago Kent Law Review* Vol. Issue 1 (December 2004) fq. 305-329.

[192] Mladen Vukčević, Komentar Ustava Crne Gore, fq. 31.

prill të vitit 1992.[193] Këtë e bënë me shpresën për të ruajtur ”tapitë” mbi Kosovën, siç e bëjnë të gjithë autorët serbë të së drejtës kushtetuese dhe ndërkombëtare, duke besuar se pas shpërbërjes edhe të **RFJ-së** (pas pavarësimit të Malit të Zi), të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga **Rezoluta 1244** do të kalojnë në Serbi.[194]Argumenti kyç është krejtësisht dogmatik dhe bazohet në dispozitën e **Marrëveshjes së 14 marsit 2002** që rregullon rishqyrtimin e gjendjen juridike pas tri viteve, në rast të largimit të ndonjërit prej dy shteteve anëtare nga Bashkësia Shtetërore. Ajo dispozitë kishte këtë përmbajtje:

“Pas tri vitesh, shtetet anëtare kanë të drejtën e fillimit të procedurave për ndryshimin e statusit shtetëror, përkatësisht për dalje nga bashkësia shtetërore. Në rast të daljes së Malit të Zi nga bashkësia shtetërore, dokumentet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me RFJ-në, në veçanti **Rezoluta 1244** e KS të OKB-së, në tërësi do të vlente për Serbinë si shtet trashëgimtar. Shteti anëtar që shfrytëzon të drejtën për dalje nga bashkësia shtetërore nuk trashëgon subjektivitetin juridik-ndërkombëtar, kurse çështjet eventuale kontestuese zgjidhen me marrëveshje në mes të shtetit trashëgimtar dhe shtetit të ri të krijuar. Nëse dy shtetet anëtare vendosin me referendum për ndryshim të statusit shtetëror me kuptim pavarësinë, atëherë në procedurën e trashëgimit krejt çështjet kontestuese do të rregullohen në mënyrë të njëjtë siç është vepruar me rastin e Jugosllavisë paraprake. Ligjet mbi referendumin i sjellin shtetet anëtare, duke marrë parasysh standardet ndërkombëtare ndërkombëtarisht të pranuara”.

Këtë formulim e kanë futur serbët me shpresë se do të pranohet kontinuiteti shtetëror i Serbisë, në veçanti ndaj Kosovës, që nga aneksimi i kësaj të fundit pas Luftës së Parë Ballkanike (1912-1913). E vërtetë është se formimi i ish-Jugosllavisë më 1 dhjetor 1918 ka qenë një akt legal dhe legjitim sipas të drejtës ndërkombëtare të kohës, sepse atëherë është lejuar përdorimi i forcës si mjet për aneksim të territoreve dhe robërim të popujve të tjerë. Me aktin e themelimit të atij shteti më 1918, me përdorim të dhunës ushtarake të shtetit serb, ka ardhur deri të gllabërimi i Mbretërisë së Malit të Zi, i territoreve të Kroacisë, Sllovenisë dhe Vojvodinës, që kishin qenë nën Austro-Hungarinë, si dhe i krejt trojeve etnike shqiptare jashtë Shqipërisë londineze. Ky veprim ligjërisht ka çuar në shuarjen e dy mbretërive – asaj serbe dhe malazeze. Ideja serbe pas shpërbërjes së ish-**Jugosllavisë** dhe themelimit të RFJ-së nga Millosheviqi më 1992 ka qenë që Serbia dhe Mali i Zi po e vazhdonin shtetësinë e tyre në shtetin e njëjtë të themeluar më 1 dhjetor 1918, meqë vetëm ato gjoja kishin futur shtetësinë e tyre me rastin e themelimit të atij shteti. Kjo, megjithatë, asnjëherë nuk është pranuar nga bashkësia ndërkombëtare gjatë tërë kohës së ekzistimit të ish-Jugosllavisë, deri në ditën e sotme.

Përndryshe, në zhvillimin kushtetues të Serbisë, konstitucionalistët serbë kanë identifikuar pesë faza.[195] Faza e parë nis me aktet me karakter kushtetues nga vitet 1808 dhe1811, periudha e konstitucionalizmit kryengritës (koha e kryengritjeve serbe kundër Perandorisë Otomane). Të kësaj faze janë edhe **Kushtetuta e Principatës së Serbisë** e vitit 1835 (“Sretenski Ustav”, që d.m.th “Kushtetuta e Ditës së Bekuar”) dhe **Kushtetuta Turke** e vitit 1838 (që ka pasur formën e Hatisherifit apo Dekretit Otoman). Këtë të fundit e ka dhuruar **Sulltani** për **Principatën e Serbisë.** Kushtetuta e parë e vitit 1835 ka qenë në fuqi vetëm gjashtë javë dhe asnjëherë nuk është zbatuar, kurse **Kushtetuta Turke** ka pasur jetën më të gjatë nga kushtetuat serbe deri më sot.

Në fazën e dytë të zhvillimit të konstitucionalizmit serb nxirren disa kushtetuta. E para ndër to është **Kushtetuta e Regjencës** (“Namesnicki Ustav”) e vitit 1869. E dyta është **Kushtetuta Radikale** e vitit 1888. E treta është **Kushtetuta e Prillit** apo **Kushtetuta e Dhuruar** e vitit 1901. Dhe,

193 Ratko Marković, *Utavno pravo i političke institucije* (Glasnik: Beograd, 2008) (vetëm në alfabetin cirilik), fq. 143-148.

194 Për historikun e kësaj ideje, cf. më shumë në Enver Hasani, *Tema të zgjedhura nga e drejta dhe marrëdhëniet ndërkombëtare* (Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina, Prishtinë, dhe JALIFAT Publishing, Huston, Teksas, SHBA, 2016) fq. 41-120.

195 Slobodan P. Orlović*, Ustavno pravo* (Pravni fakultet u Novom Sadu: 2019) (në alfabetin cirilik vetëm), fq. 22-23.

së fundi është Kushtetuta e vitit 1903, që e ka miratuar **Kuvendi Popullor Serb** më 5 qershor 1903 dhe ka qenë në fuqi deri në krijimin e ish-Jugosllavisë më 1 dhjetor 1918. Edhe këtu, siç mund të vërehet, aktet me rëndësi kushtetuese të fillimit të hershëm të konstitucionalizmit në këtë vend fqinj kanë qenë të draftuara me ndikimin e fuqishëm të faktorit të jashtëm. Kjo nënkupton se edhe këtu, njëjtë si në rastin shqiptar, ushtrimi i pushtetit konstituiv origjiner ka qenë i kufizuar, siç ka qenë vetë ushtrimi i sovranitetit shtetëror. Përjashtim i vetëm ekziston sa i përket Kushtetutës së vitit 1903, që është draftuar dhe miratuar nga një kuvend serb. Me këtë kushtetutë futet në jetë sistemi parlamentar dhe vihen kufizime shtesë në pushtetin e kurorës, në ndërkohë që të tjerat kushtetuta kishin qenë shembuj tipik të konstitucionalizmit autoritar.

Faza e dytë ka të bëjë me kushtetuat e ish-**Jugosllavisë monarkike**, më fillim nga **Kushtetuta e Vidovdanit** (1921) dhe **Kushtetuta e Dhuruar** (1931). Kjo e fundit gjithashtu shërben si një shembull i konstitucionalizmit autoritar, në ndërkohë që e para ka promovuar një sistem parlamentar, përkundër që qeveria ka qenë përgjegjëse para monarkut dhe parlamentit. Me këtë mbyllet kjo fazë, për të lëshuar vend zhvillimit të konstitucionalizmit në Jugosllavinë komuniste. Kjo është faza e katërt. Në këtë fazë kanë ekzistuar katër kushtetuta, që kanë vlejtur njëjtë edhe për Kosovën dhe vendet tjera fqinjë, që janë zënë në gojë më sipër. Ato kanë qenë kushtetutat komuniste të viteve 1946, 1953 (ligj kushtetues), 1963 dhe 1974. Secila prej tyre kanë pësuar amendamentime të konsiderueshme. Këto kushtetuta kanë disa karakteristika të përbashkëta, siç janë: mbështetja e tyre në parimin e unitetit të pushtetit, sistemin kuvendor dhe rregullimin shoqëror socialist të bazuar në konceptin teorik mbi demokracinë popullore. Në fund vjen periudha e pestë dhe e fundit në zhvillimin e konstituticonalizmit në Serbi dhe fillon me **Kushtetutën e vitit 1990**. Me këtë kushtetutë sanksionohet rrënimi i autonomisë së **Kosovës** dhe shtypja brutale e vullnetit politik të shqiptarëve. Krejt kjo përkundër proklamimit në të të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, parlamentarizmit racional dhe një katalogu të gjerë të lirive dhe të drejtave kushtetuese që kanë të bëjnë me individin dhe popujt tjerë joserb. Edhe në këtë fazë, megjithatë, bëhet fjalë për Serbinë si njësi federale sepse ish-**Jugosllavia** ka ekzistuar deri më 27 prill 1992, kur ndërkombëtarisht merret si datë e fundit e shpërbërjes së saj. Për këtë arsye, konstitucionalizmi serb këtu ngelet brenda kornizave formale të **Kushtetutës së Zhabljakut**, ani se tërësisht e dominuar nga serbët dhe hegjemonia e tyre, me **Millosheviqin** si simbol i kësaj hegjemonie dhe regjimit autoritar serb. **Karta Kushtetuese** e vitit 2003 ngelet kushtetuta e fundit e shtetit të përbashkët serbo-malazez, **RFJ**, që u krijua në pranverë të vitit 1992, që formalisht proklamonte parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, respektimin dhe promovimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe minoriteteve, sundimin e ligjit dhe demokracisë. Në praktikë, megjithatë, ka qenë sundim autoritar i diktatorit serb Millosheviq, ai që ka funksionuar deri me rrëzimin e tij nga pushteti: për konstitucionalizëm si koncept që përshkruan kufizimin e pushtetit as që mund të bëhet fjalë në këtë kohë, sepse kushtetutat serbe kanë qenë dokumente fiktive dhe nominale që kanë përligjur një sistem represiv politik.

5. E drejta kushtetuese

Në këtë seksion diskutohet e drejta kushtetuese në tri dimensionet e saj kryesore, si degë e sistemit juridik pozitiv, pra si shtjellim i pozitës së dispozitave kushtetuese në sistemin juridik, si degë e shkencës juridike, pra si tërësi e njohurive tona mbi të drejtën kushtetuese, dhe si metodë, pra si rrugë që duhet ndjekur dhe mjetet që duhen përdorur zakonisht për të gjeneruar njohuri mbi të drejtën kushtetuese.

5.1. E drejta kushtetuese si degë e sistemit juridik pozitiv, si disiplinë shkencore dhe metoda e të drejtës kushtetuese

5.1.1. E drejta kushtetuese si degë e sistemit juridik pozitiv

E drejta kushtetuese është degë e të drejtës publike, e cila në kuadër të sistemit juridik përmban (ngërthen) dispozita që rregullojnë **materien kushtetuese**. Objekt i kësaj dege të së drejtës është kushtetuta dhe

aktet tjera juridike që kanë të bëjnë me rregullimin e pushtetit, organizimin dhe funksionimin e tij, si dhe garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Sipas kriterit material (përmbajtësor) dhe formal (lloji i burimeve të së drejtës), e drejta kushtetuese mund të konsiderohet dega themelore e sistemit juridik. Me mbështetje në të drejtën kushtetuese ndërtohet sistemi juridik. Ajo është kulmi i këtij sistemi për faktin se krijon instrumentet themelore për mbrojtjen e tij.

Për shkak të rëndësisë së çështjeve që normon, që kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionimin e shtetit dhe pushtetit si dhe me statusin e individit në shoqëri, nuk është gabim të thuhet se e drejta kushtetuese është dega themelore e sistemit juridik (**kriteri material**). Se e drejta kushtetuese ka rëndësi thelbësore për sistemin juridik, mund të konkludohet edhe për faktin se burimi kryesor i të drejtës kushtetuese, kushtetuta, përbën burim të së drejtës për të gjitha degët tjera të së drejtës: administrative, penale, civile dhe të gjitha degëve të tjera (**kriteri formal**). Kushtetuta përmban norma me të cilat rregullohen segmente të caktuara të degëve të tjera të së drejtës, siç janë, ta zëmë, dispozitat kushtetuese procedurale lidhur me të drejtat e të akuzuarit janë materie e të drejtës procedurale penale, dispozitat mbi punën i përkasin të drejtës së punës dhe kështu me radhë. Krahas të qenurit burim i së drejtës, kushtetuta përcakton bazën juridike për nxjerrjen e ligjeve për degët tjera të së drejtës, organin ligjvënës si dhe elementet themelore të procedurës së ligjvënies.

Për shkak të përmbajtjes së saj dhe faktit që kushtetuta është akti më i lartë juridik dhe burim edhe i degëve të tjera të së drejtës, e drejta kushtetuese ka pozitën sipërore kundrejt degëve të tjera të së drejtës. Me të drejtën kushtetuese, megjithatë, vetëm pjesërisht dhe në një mënyrë të përgjithshme (abstrakte) rregullohen çështjet nga degët tjera të së drejtës, që zakonisht janë çështjet më të rëndësishme.

5.1.2. E drejta kushtetuese si disiplinë shkencore

Si disiplinë shkencore, e drejta kushtetuese lajmërohet dhe gradualisht zhvillohet në Angli, Francë, Itali, SHBA dhe Gjermani. Në kuptimin bashkëkohor të fjalës, megjithatë, konsiderohet se, për herë të parë është themeluar, në **Francë**, pas revolucionit të korrikut 1830, në **Fakultetin Juridik** të **Universitetit të Parisit** (1834). Shkëndijat e para të lindjes së një disipline të re shkencore që do të ketë për objekt studimi të drejtën kushtetuese janë të mëhershme dhe datojnë nga koha pas nxjerrjes së Deklaratës së vitit 1789, kur u shfaq tendenca për mësim të së drejtës kushtetuese nëpër shkollat publike fillore franceze, si një lloj **katekizmi i ri republikan**.[196] Këtë ide e kishte nisur **Tallejrand** (Charles-Maurice de Talleyrand-Périgord: 1754-1838), që kishte shërbyer si kryediplomat i mbretërve francezë, por edhe në kohën e **Napoleonit** (Napoléon Bonaparte: 1769-1821). Në një raport të tij për **Asamblenë Kushtetuese** të datës 10 shtator të vitit 1791, ai glorifikonte Deklaratën e vitit 1789, si një dokument me rëndësi të madhe kushtetuese që kërkonte të mësohej nga popullsia e zakonshme. Që kjo punë mos të lihej në duart e sharlatanëve, siç e thoshte **Tallejrand**, u propozuan disa masa që duheshin ndërmarrë si pjesë e arsimit publik.[197] Ky entuziazëm u shoqërua me një urdhër tjetër të **Asamblesë Kushtetuese**. Ai kishte të bënte me mësimin e Deklaratës dhe Kushtetutës nëpër fakultetet juridike franceze. Bëhet fjalë për urdhrin e datës 26 shtator të viti 1791. Në fakt, në kohën e nxjerrjes së këtij urdhri, në **Nansi** (Nancy) veç kishte filluar mësimi i tyre. Kjo u ndoq nga **Fakulteti Juridik i Dizhonit** (Dijon) në vitin 1792, në ndërkohë që zhvillimi më interesant në këtë sferë kishte ndodhur në të njëjtin vit në **Liceun e Parisit**, institucion privat i arsimit, ku nisi mësimi superior jo vetëm i Kushtetutës së vitit 1791, por edhe i kushtetutave antike, kushtetutave evropiane të kohës si dhe **Kushtetutës së SHBA-së**. Kjo u bë nga një avokat parisien, **Delakrua** (Jacques-Vincent *Delacroix*: 1743-1832), i cili për kursin mbi mësimin e kushtetutës kishte

[196] **Katekizmi** është mësimi fillestar mbi doktrinën kishtare dhe gjërat themelore të besimit kristian.

[197] Talleyrand Périgord Charles Maurice de, "Rapport par M. Talleyrand-Périgord, ancien évêque d'Autun, sur l'instruction publique, en annexe de la séance du 10 septembre 1791". Në *Archives Parlementaires de 1787 à 1860- Première série (1787-1799)*. Tome XXX- Du 28 août au 17 septembre 1791. Paris: Librairie Administrative P. Dupont, 1888, fq. 447-480 në fq. 448-450. Në internet: https://www.persee.fr/doc/arcpa_0000-0000_1888_ num_ 30_1 _1 2472_t 1_0447_ 0000_8 (shikuar në mars 2022).

botuar një libër në gjashtë vëllime, në mijëra faqe, që u ribotua disa herë më pas.[198] Në këtë libër të tij, i pari i llojit të vet në botë, autori shtjellon nga aspekti i civilizimit perëndimor lindjen dhe zhvillimin e kushtetutave në dy anët e **Atlantikut**, që nga kohët antike deri në kohën e shkrimit të tij.

Me kalimin e kohës, kushtetutat më nuk shiheshin si një lloj teknike për ushtrimin e pushtetit, por si instrumente për kufizimin e tij. Mbi të gjitha, ato shiheshin si instrumente thellësisht përcaktuese dhe domethënëse për natyrën, mënyrën e organizimit dhe ushtrimit të pushtetit. Një orientim si ky u reflektua në dekretin e Ministrit francez të Arsimit, **Gizo** (François Pierre Guillaume Guizot: 1787-1874), të datës 22 gusht 1834, me të cilin u krijua katedra e të drejtës kushtetuese në **Fakultetin Juridik të Parisit (Sorbonë)**. Arsyetimi për hapjen e kësaj katedre kishte të bënte pikërisht me mësimin e studentëve për mënyrën e funksionimit të institucioneve të përcaktuara me Kartën e re Kushtetuese, si dhe mbi garancionet e të drejtave individuale që ajo i ofronte. Ky mësim duhej të bëhej jo nga këndi i filozofisë politike, siç kishte qenë deri atëherë por edhe më vonë në tokat italiane, por nga këndi i drejtës kushtetuese pozitive franceze që sanksionohej me Kodin Kushtetues (siç e quajti **Gizo** Kartën e vitit 1830).[199] Detyrën e shefit të parë të katedrës të së drejtës kushtetuese e ushtroi **Pelegrino Rosi** (Pellegrino Rossi: 1787-1848), një intelektual i brumosur thellë me ide liberale që në kohën e lirisë italiane nën Francën pas vitit 1790.[200]

Në kuptimin më të gjerë të fjalës, e drejta kushtetuese bënë pjesë në grupin e shkencave shoqërore, kurse në kuptimin e ngushtë ajo është pjesë e të drejtës publike që studion dhe hulumton të drejtën publike, institutet dhe marrëdhëniet juridiko-publike. Ato janë marrëdhënie mes shtetit, si autoritet publik, dhe qytetarit, si individ me subjektivitet juridik. Pikërisht për shkak të natyrës së këtyre marrëdhënieve, me kohë, në **Francë**, fjalës "e drejta kushtetuese" (**Le droit constitutionnel**) iu shtua edhe fjala tjetër- "institucionet politike" (**Les institutitions politiques**). Kjo për të vënë theksin në rëndësinë që ka organizimi i pushtetit. E drejta kushtetuese e kësaj periudhe, për pasojë, është e **drejtë kushtetuese institucionale**, ku fokus i analizës dhe shtjellimit janë praktikat e funksionimit të institucioneve kushtetuese, gjë që është reflektuar edhe në librat me këtë lëndë përgjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX e deri në vitin 1997. Në **Gjermani**, në anën tjetër, është futur në përdorim një shprehje tjetër për të përshkruar meterien që sot normon e drejta kushtetuese - shprehja "e drejta shtetërore" (**Staatsrecht**). Lajmërimi i shprehjes **e drejtë shtetërore** lidhet me dogmatikën gjermane, e cila ka gjetur mbështetjen e saj në botëkuptimin filozofiko-juridik hegelian mbi shtetin si një fuqi krijuese e pavarur e shoqërisë. Sipas pikës nisëse të kësaj teorie, bërthama e organizimit politik të shoqërisë është pushteti shtetëror dhe organizimi i tij, në ndërkohë që prapavija e tij politike përbëhet nga bashkimi i shteteve të vogla gjermane në një shtet të fuqishëm të centralizuar me rregullim monarkik.

Dogmatika gjermane e kohës e ka kuptuar kushtetutën si njërin prej mjeteve juridike përmes së cilës shteti shpreh dhe realizon vullnetin e vet të pakufizuar dhe absolut, pa e konsideruar atë si një akt që konstituon shtetin. Të drejtat e njeriut dhe sovraniteti i popullit nuk paraqesin asnjë vlerë kundrejt pushtetit shtetëror. Përkundrazi, të kuptuara si kategori juridike dhe elemente të rendit juridik që e krijon shteti,

198 Cf. Jacques-Vincent Delacroix, *Constitutions des principaux états de l'Europe et des États-Unis de l'Amérique* (Buisson: Paris, 1791 à 1801).

199 Në raportin e tij, dërguar mbretit më datën 22 gusht 1834, Gizot tregon arsyet për themelimin e katedrës së të drejtës kushtetuese. Aty thotë, në mes tjerash, se (në katedër): "[...] Do të mësohen Karta Kushtetuese dhe liritë individuale që ajo garanton, institucionet politike që ajo sanksionon. Karta nuk do të jetë më një sistem i thjeshtë filozofik në duart e njerëzve të padijshëm; ajo do të jetë një e drejtë e njohur dhe e shkruar, që duhet të mësohet dhe arsyetohet … Një lëndë e tillë mësimi e studimi duhet t'i zëvendësoj gabimet e injorantëve dhe ideve të tyre të tepërta me dije të fuqishme dhe positive". Cf. Aurelian Craiutu., *Liberalism under Siege: The Political Thought of the French Doctrinaires* (Lexington Books: USA, 2003), kapitulli 6 ("Political Power and the 'New Means of Government') fq. 155-185 në fq. 175-176. Cf. edhe Louis Favoreu, Patrick Gaïa, Richard Ghevontian... [et al.], *Droit constitutionnel* 19e édition (Dalloz: Paris, 2017), fq. 14.

200 Jean-Louis Mestre, "Le emplois initiaux de l'expression 'droit constitutionnel", «Revue française de droit constitutionnel Vol. 3 No. 55 (2003), fq. 451-472 fq. 471 (autori thekson se kjo katedër, zyrtarisht e para në një universitet publik në Francë, është themeluar 60 vjet pas vënies në përdorim të shprehjes "e drejta kushtetuese " në këtë vend).

të drejtat e njeriut dhe sovranitetit i popullit nuk janë asgjë tjetër pos emanacion apo produkt i pushtetit shtetëror.

5.1.3. Metoda e të drejtës kushtetuese

E drejta kushtetuese si një disiplinë shkencore studion tërësinë e rregullave dhe praktikave që cilësohen si kushtetuese, sipas një metodologjie të caktuar. Metodat e saj, **grosso modo**, mund të përmblidhen në dy grupime: në **metodat natyraliste** të së drejtës kushtetuese dhe në **metodat pozitiviste** të së drejtës kushtetuese. Natyralistët insistojnë në atë se studimi i së drejtës kushtetuese duhet të niset nga e drejta natyrore. Me këtë koncept nënkuptohet krijuesi apo natyra, natyra njerëzore apo arsyeja humane dhe kështu me radhë. Kjo qasje teorike në veçanti ka dhënë kontribut në lëmin e lirive dhe të drejtave njerëzore sepse konsideron se konsideratat e drejtësisë duhet të mbizotërojnë kur vije puna të respektimi dhe promovimi i lirive dhe i të drejtave njerëzore, pa marrë parasysh nëse të njëjtat janë të shkruara në kushtetutë. Kjo qasje, përveç në këtë lëmi, ka dhënë kontribut të çmuar edhe në lëmin e legjitimitetit të pushtetit politik. Metodat pozitiviste, ndërkaq, nisen nga presupozimi se disiplina e të drejtës kushtetuese nuk mund të ketë për objekt studimi të drejtën natyrore, por vetëm të drejtën pozitive, atë të drejtë që manifeston një vullnet konkret. Për pasojë, juristët kushtetues duhet të merren me studimin vetëm të atyre normave që janë pozitive dhe që ekzistojnë. Çdo qasje tjetër, sipas tyre, përbën moral dhe subjektivizëm. Kjo ndryshe njihet edhe si qasje dogmatike juridike, për dallim nga qasja sociologjike.

Për **metodën pozitiviste** përdoren emra të ndryshëm, më së shpeshti shprehjet **metoda juridike (normative)** dhe **metoda dogmatike** (**metoda juridiko-pozitive).**[201] Sidoqoftë, këtu nuk bëhet fjalë për një metodë, por për tërësi metodash, për shkak se e drejta kushtetuese është një dukuri shoqërore dhe, si çdo dukuri shoqërore, ka një pikë nisëse dhe zhvillimi. Për të rrokur (kapur) këtë pikë në tërësinë e saj, studiuesit dhe hulumtuesit, duhet medoemos të mbështeten në një larushi metodash, mirëpo metoda pozitiviste qëndron në krye të tyre dhe është më e përhapura. Brenda kësaj metode mund të dallohen **metoda e interpretimit tekstual**, **metoda e shpjegimit të normave kushtetuese** (ekzegjeza/hermeneutika) dhe **metoda deontologjike**, e cila, përmes hulumtimit të normave ekzistuese, projekton se si duhet të duken ato, në mënyrë që të realizohen vlerat që mbron kushtetuta (demokracia, sundimi i ligjit, liritë dhe të drejtat e njeriut). Në vendet që nuk i takojnë konstitucionalizmit liberal të proveniencës perëndimore, vlerat që mbron kushtetuta mund të jenë krejtësisht tjera, të ankoruara edhe në tekste e koncepte filozofiko-politike jashtë kushtetutës zyrtare (ta zëmë, librat e shenjta fetare, besimet e ndryshme, ideologjitë politike totalitare dhe kështu me radhë). Në këto raste, as që mund të bëhet fjalë për metodë juridike, për shkak se çdo interpretim është i paracaktuar dhe i rrënjosur që më parë në një të vërtetë tjetër nga ajo që sanksionohet në dispozitat kushtetuese.

Ajo që dallon **metodën pozitiviste** të së drejtës kushtetuese nga metodat e shkencave të tjera juridike ka të bëjë me veçantinë e objektit të hulumtimit, i cili ka të bëjë me institucionet kushtetuese dhe politike. Për këtë arsye është i domosdoshëm shfrytëzimi i **metodës politologjike**, me të cilën hulumtohet suksesi me të cilin funksionon pushteti ekzekutiv, parlamenti, gjyqësori dhe institucionet tjera dhe sa, në kuptimin objektiv, realizohen normat kushtetuese që rregullojnë jetën dhe punën e institucioneve publike në përgjithësi.

E drejta kushtetuese shfrytëzon edhe **metodën juridike-krahasimore**, me të cilën analizohen dhe krahasohen dispozitat kushtetuese dhe institucionet politike në shtetet tjera dhe, në bazë të kësaj, nxjerrin përfundime shkencore.

Një metodë tjetër me rëndësi është **metoda historike**, e cila në të drejtën kushtetuese shërben për të hulumtuar zhvillimin e kushtetutës dhe kushtetutshmërisë, temat mbi organet e pushtetit dhe liritë e të drejtat e njeriut në të kaluarën.

---

[201] Francis Hamon dhe Michel Trope, *Droit constitutionnel*. 37e edition (Paris: L. G.D.J., 2016) fq. 40-47.

Së fundi, **metoda sociologjike** shërben për të analizuar dhe studiuar kushtetutën si një dukuri shoqërore dhe civilizuese, duke provuar të jap përgjigje në atë se cilët janë shkaqet dhe arsyet shoqërore që prodhojnë aktin më të lartë juridik, cilat janë pasojat që prodhohen nga krijimi i kushtetutës, si ndikon shoqëria si tërësi në ndryshimin e kushtetutës dhe në çfarë mase zgjidhjet ekzistuese kushtetuese i përgjigjen realitetit shoqëror.

5.2. Marrëdhënia e të drejtës kushtetuese me degët tjera të së drejtës

Krejt e drejta ndahet në të drejtën publike dhe në të drejtën private. E bërë nga juristi romak **Ulpiani** (Gnaeus Domitius Annius Ulpianus: 170-223/228), këshilltari juridik i perandorit **Aleksander Severus** (Marcus Aurelius Severus Alexander: 208-235), kjo ndarje i ka qëndruar shekujve e sfidave të kohës.[202] Ka pësuar ngecje dhe modifikime, por asnjëherë, në thelb, nuk është hedhur poshtë në tërësi si një ndarje. Në praktikë, ndërkaq, shteti feudal dhe shteti absolut nuk bënin dallimin në mes të drejtës publike dhe të drejtës private: i pari, sepse ishte tepër i fragmentarizuar dhe marrëdhëniet e mbretit me feudalët dhe subjektet e tij bazoheshin në marrëdhënie kontraktuale; i dyti, ndërkaq, absorboi në tërësi sferën private. Me lindjen e shtetit liberal, u bë ndarja e qartë në mes të sferës publike dhe sferës private, si një cilësi themelore e shtetit modern që pasoi shtetin feudal.[203]

Degët e së drejtës që i përkasin të **drejtës publike** rregullojnë marrëdhëniet juridike në mes të individit dhe subjekteve të tjera të së drejtës private dhe shtetit. Këta janë subjekte të pabarabartë. Në këtë grup të degëve hyn edhe e drejta kushtetuese. E drejta publike është e pandashme nga pushteti shtetëror apo qeverisja. Në të drejtën private, ndërkaq, qeveria shërben si një lehtësuese e marrëdhënieve horizontale në mes të palëve private. Këta janë subjekte të barabartë.[204] Në këtë kuptim, e drejtë publike mund të konsiderohet çdo rregullativë juridike që ka të bëjë me shtetin dhe marrëdhëniet shtetërore (publike), kurse e drejtë private çdo marrëdhënie që nuk ka të bëjë me shtetin dhe marrëdhëniet shtetërore (publike).[205]

Ajo që më së shumti asocohet me të drejtën publike, shikuar historikisht, është ai grup i rregullave dhe parimeve që formojnë të drejtën kushtetuese. Si degë e së drejtës publike, e drejta kushtetuese

---

202 "Publicum ius est quod ad statum rei Romanae spectat, ius privatum est quod ad singulorum utilitatem" ("E drejta publike është e drejt që ka të bëjë me interesin e shtetit, kurse e drejta private ka të bëjë me interesat e individëve privat"). Cf. më shumë në Barbara Grabowska, "Horizontal Impact of Human Rights – Dialogue Between Constitutional and International Law". Në Kyriaki Topidi & Lauren Fielder (eds.), *Transnational Legal Processes* (Routledge: London and New York, 2013) fq. 63-78 në fq. 63.

203 Ekzistojnë dy lloje të shtetit absolut: **shteti absolut empirik** dhe **shteti absolut i përndritur**. Gjatë kohës së shtetit absolut empiric, vitet 1500-1700, akoma vjen deri t ngatërrimi i fuqishëm në mes të sferës publike dhe sferës private: shteti patrimonial, ku nuk bëhet dallim në mes të pronës shtetërore dhe pronës së kurorës, si dhe në mes të punëve publike dhe punëve private, vazhdon jetën me modifikime të caktuara. Në kohën e shtetit absolut të përndritur, fundet e viteve 1700, bëhet fjalë për shtetin që synon të përkujdeset, dhe ndjek qëllime, për të mirën e përgjithshme. Në fund vijnë dy revolucionet, në **Amerikë** dhe **Francë, q**ë kurorëzojnë triumfin e **shtetit liberal** dhe ndarjen përfundimtare praktike në mes të asaj që është **sferë publike** dhe asaj që është **sferë private**. Cf. më shumë trajtimin e shkëlqyer të kësaj tematike, në Mauro Volpi, *Libertà e autorità. La classificazione delle forme di Stato e delle forme di governo.* Settima edizione (G. Giappichelli Editore: Torino, 2018) fq. 27-41.

204 Cf. Më shumë në Michel Rosenfeld, "Contract and Justice: The Relation Between Classical Contract Law and Social Contract Theory". *Iowa Law Review* Vol 70 No. 4 (May 1985) fq. 769-900 në fq. 866–867 (këtë konstatim autori i nxjerr nga krahasimi i ideve të **Tomas Hobsit** dhe **Xhon Lokut** sa i përket kontratës sociale: i pari konsideron se kontrata nënkupton dorëzim të tërësishëm në mëshirim e vullnetit të sovranit, kurse i dyti konsideron se bartja e të drejtave në sovranin ka formën e kujdestarisë apo bartjes me mirëbesim, përmes së cilit barten detyrat për të mbrojtur pronën, sigurinë dhe lirinë, gjithnjë me rezervën e revokimit të këtij bësimi të bartur kurdo që abuzohet me te nga ana e kujdestarit në të cilin janë bartur autorizimet për qeverisje; vetëm pikëpamja e dytë i jep kuptim ndarjes në të drejtën publike dhe të drejtën private, në ndërkohë që pikëpamja e parë humb dallimin në mes tyre).

205 Michel Rosenfeld, "Rethinking the boundaries Between public Law and private Law for the twenty first century: An introduction" *International Journal of Constitutional Law,* Vol. 11 No. 1 (February, (2013), fq. 125–128 në, fq, 125.

përfshinë normat juridike që rregullojnë marrëdhëniet e pushtetit politik. Si në kuptimin material ashtu edhe në kuptimin formal, e **drejta kushtetuese pozitive** përbën degën më të rëndësishme të së drejtës. Në bazë të normave të së drejtës kushtetuese ndërtohet sistemi juridik, nga themeli deri në kulm. Kjo degë përcakton mekanizmat, instrumentet (mjetet) dhe procedurat e mbrojtjes së këtij sistemi. Një kohë të gjatë, e drejta kushtetuese ka ekzistuar me emrin e drejtë publike dhe, për aq sa ka pasur të bëjë me origjinën, organizimin dhe funksionimin e pushtetit shtetëror, është cilësuar si e **drejtë politike**. Procesi i ndarjes së të drejtës kushtetuese dhe formimit të saj si degë e veçantë ka nisur intensivisht në gjysmën e dytë të shek. XIX.

Rëndësia dhe pozita e normave kushtetuese në të drejtën kushtetuese është i ndryshëm nga rëndësia dhe pozita e tyre në kuadër të degëve të tjera të së drejtës. Në të drejtën kushtetuese, normat kushtetuese shfaqen si **norma fillestare dhe përfundimtare**, përkatësisht të parat dhe të fundit, sepse më tutje në kushtetutë ato nuk përpunohen. Brenda dhe kundrejt krejt degëve të tjera të së drejtës, ndërkaq, normat kushtetuese janë **norma themelore dhe fillestare** për arsye se përpunohen më tutje duke u shndërruar në shumësi normash të tjera juridike, të cilat, në të njëjtën kohë, shërbejnë si instrumente zbatimi i normave kushtetuese. E thënë me fjalë të tjera, cilësia e fundit derivohet nga fakti se, e drejta kushtetuese nuk i përpunon normat e saj në detaje të tjera, duke ua lënë këtë detyrë degëve të tjera të së drejtës, gjë që shpie në konkluzionin se normat e njëjta kushtetuese në degët tjera të së drejtës janë norma themelore dhe fillestare në të njëjtën kohë. Normat e degëve të tjera të së drejtës, në këtë kuptim, paraqiten si kusht për aplikim të normave kushtetuese.[206]

Kjo është arsyeja pse e drejta kushtetuese mban pozitë superiore ndaj degëve të tjera të së drejtës: ajo normon bazat themelore dhe aspektet kryesore që prekin të gjitha degët tjera të së drejtës, duke shërbyer si bazë për aktivitetin e tyre juridiksional dhe normativ. Pa normat kushtetuese, shteti modern as që mund të ekzistojë sepse, në veçanti në shtetet demokratike, ato informojnë dhe kushtëzojnë tërë jetën e brendshme juridike, publike dhe private. Siç e ka thënë **Pelegrino Rosi**, doajeni i të drejtës kushtetuese si degë e shkencës juridike, në të drejtën kushtetuese gjenden kokat e kapitujve të degëve të tjera të së drejtës ("les têtes des chapiters"),[207] në sensin që kryerja e aktiviteteve të ndryshme të shtetit është legjitime vetëm për aq sa ato aktivitete ushtrohen në pajtim me parimet që shteti i ka vënë në kushtetutën e vet.[208] Ky fakt paraqet pikënisjen për vlerësimin e marrëdhënies të së drejtës kushtetuese me degët tjera të së drejtës pozitive: e drejta kushtetuese pozitive përbën rendin suprem të shtetit.

E drejta kushtetuese ka më së shumti pika takimi me të **drejtën administrative**, e cila, në kuptimin organik, rregullon pozitën dhe punën e organeve shtetërore-organeve të administratës. Ministrat në qeveri janë pjesë e pushtetit ekzekutiv, i cili është objekt normimi i të drejtës kushtetuese, por njëkohësisht edhe në krye të resorëve (ministrive) përkatëse, që janë objekt rregullimi i të drejtës administrative. Në traditën gjermane të së drejtës, e drejta kushtetuese dhe e drejta administrative, për një kohë të gjatë kanë qenë të lidhura me të njëjtin emër- **e drejtë shtetërore**. Sot kjo nuk është kështu sepse procedura administrative, konflikti administrativ dhe akti administrativ bëjnë pjesë në materien e të drejtës administrative gjermane.

E drejta kushtetuese është e lidhur edhe me të **drejtën penale** (materiale dhe procedurale). Kushtetutat përmbajnë dispozita që kanë natyrë proceduralo-juridike, të cilat për shkak të rëndësisë së tyre gjenden në katin më të lartë juridik. E kemi fjalën për parimin e legalitetit të veprës penale dhe sanksionit, prezumimin e pafajësisë, të drejtën për mbrojtje me përfaqësues profesional, ndalimi i

---

206 Brano Smerdel & Smiljko Sokol, *Ustavno pravo.* ***Četvrto*** neizmenjeno izdanje (Narodne Novine: Zagreb, 2009), fq. 14.

207 Cituar sipas Carlo Lavagna, *Istituzioni di diritto publi*co. Volume primo (Unione Tipografico – Editrice Torinese: Torino, 1970), fq. 197.

208 Emilio Crosa, "Diritto costituzionale". *Novissimo Digesto Italiano* Vol. V (Tipografia Cane & Durante: Torino, 1968) fq. 829-834 në fq. 829.

retroaktivitetit, **ne bis in idem**, karakteri individual i përgjegjësisë penale, kushtet për privim nga liria dhe paraburgimi, kushtet e mbajtjes së dënimit me burg. Vetëm gjykimi, pozita e gjyqtarëve dhe prokurorisë normohen me rregullat procedurale penale, në ndërkohë që parimet më të rëndësishme mbi pushtetin gjyqësor dhe prokurorinë gjenden në kushtetutë.

Normat kushtetuese që rregullojnë këto garancione kushtetuese të karakterit penalo-procedural nuk përpunojnë më tutje të njëjtat, por shërbejnë si themel për përpunim të tyre përmes legjislacionit penal. Kjo është kështu për shkak se, **garancionet kushtetuese** të këtij lloji, në të shumtën e rasteve janë të vetëekzekutueshme dhe ngjasojnë me dispozitat ligjore penale të natyrës procedurale. Për nga natyra e tyre juridike, normat e tilla kushtetuese në të njëjtën kohë janë edhe norma penale, apo norma penale në të drejtën kushtetuese, mirëpo zënë një vend tërësisht të ndryshëm në secilën prej këtyre dy degëve të së drejtës: në të drejtën kushtetuese, këto garancione janë norma të para dhe të fundit të kësaj natyre, kurse në legjislacionin penal që eventualisht i përpunon më tutje, këto norma shërbejnë si themel dhe udhëzues për sa i përket përmbajtjes së normave penalo-juridike që operacionalizojnë normat kushtetuese si më sipër. Kjo vlen edhe për sistemin e të drejtës së përgjithshme, në të cilin normat kushtetuese formohen dhe veprojnë jashtë një kuadri formalo-juridik hierarkik.[209] Vlen të theksohet se, në fakt, në truallin evropian, e drejta e BE-së dhe KEDNJ-së ka ndikuar fuqishëm në fshirjen e dallimeve në mes të dy sistemeve të së drejtës në sferën penale (materiale dhe procedurale) për shkak se ka nxitur dhe imponuar një qasje arsyetuese nga këndi i të drejtës kushtetuese që formohet në bazë të interpretimeve të gjykatave evropiane në Luxemburg dhe Strasburg. Kjo ka përfshirë se garancionet kushtetuese të karakterit penal-procedural ashtu edhe të drejtën penale materiale dhe parimet e saj.[210] **Kosova** dhe vendet përreth nuk bëjnë përjashtim në këtë drejtim. Shumë rrallë në kushtetutë gjenden dispozita të së **drejtës penale materiale**. Të një natyre të tillë mund të jenë normat kushtetuese që përcaktojnë veprën penale të tradhtisë së lartë, që nuk janë të rralla nëpër kushtetutat e vendeve demokratike. Kjo nuk nënkupton, megjithatë, se gjykatat mund të gjykojnë duke u bazuar në nenet konkrete kushtetuese që normojnë veprën penale të tradhtisë së lartë. Ato çdo herë duhet të thirren në dispozitat e ligjit penal që operacionalizon figurën e veprës penale të tradhtisë së lartë. Në rastin e garancioneve kushtetuese të natyrës procedurale-juridike, siç u përshkruan më sipër, gjendja paraqitet shumë më ndryshe: ato mund të zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, dhe duhet të zbatohen, në mungesë të legjislacionit adekuat që vë në jetë të njëjtat garancione kushtetuese të natyrës penale-procedurale. Pa to një proces penal nuk mund të jetë i rregullt.

E drejta financiare rregullon mënyrën e financimit të shtetit, përkatësisht të hyrat publike: tatimet, sistemin doganor, shpenzimet publike, bazat dhe mënyrën e formimit të buxhetit, auditimin. Disa prej këtyre çështjeve kanë gjetur vend në kushtetutë, duke u bërë materie e të drejtës kushtetuese: miratimi i ligjit për buxhetin, rregullimi parimor i buxhetit, institucioni i auditimit dhe çështje të ngjashme.

E drejta ndërkombëtare dhe e drejta kushtetuese takohen në mënyrën më të qartë dhe më të hapur në materien e lirive dhe të drejtave të njeriut. Kjo nuk është e tëra, megjithatë, sepse e drejta kushtetuese normon marrëdhënien në mes të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës së brendshme, duke bërë të qartë nëse vendi i takon modelit dualist apo monist të marrëdhënies në mes të këtyre dy degëve të së drejtës. Kur bëhet për liritë dhe të drejtat e njeriut, konventat, marrëveshjet dhe instrumentet e kësaj fushe kanë epërsi dhe privilegjohen ndaj të drejtës së brendshme, përfshirë edhe rastet e vendeve kur këtyre dokumenteve iu njohin statusin e normave kushtetuese, siç është rasti me Kosovën dhe Bosnje-Hercegovinën. Një kategori e rëndësishme e të drejtës ndërkombëtare janë dispozitat e të drejtës zakonore ndërkombëtare, që

[209] Cf. Lidhur me sistemin britanik dhe kanadez të konstitucionalizmit të së drejtës penale (materiale dhe procedurale), cf. më shumë në Benjamin L. Berger, "Constitutional Principles in Substantive Criminal Law". (2014). *Osgoode Legal Studies Research Paper Series*. 54. Në internet: http://digitalcommons.osgoode.yorku.ca/olsrps/54. (shikuar në gusht 2021).

[210] Cf. më shumë analizën e shkëlqyer të autorëve: Ester Herlin-Karnell, "The Power of Comparative Constitutional Law Reasoning in European Criminal Law Procedure". *Vienna Journal on International Constitutional Law* Vol. 13 No. 1 (2019). Në internet: https://doi.org/10.1515/icl-2018-0047 (shikuar në gusht 2021); Adan Nieto Martin, "*Saudade* of the constitution: The relationship Between constitutional and criminal Law in the European context". *Journal of European Criminal Law* Vol 10 N0. 1 (2019) fq. 28–33.

zakonisht në kushtetutë cilësohen si "norma përgjithësisht të pranueshme të së drejtës ndërkombëtare", të cilave kushtetutat u kushtojnë rëndësi dhe normojnë raportin e tyre me të drejtën e brendshme.

Kushtetutat rregullojnë një sërë lirish dhe të drejtash që kanë karakterin e normave nga e **drejta e punës dhe sigurimi social**. Kjo bënë që këto liri dhe të drejta të futen në grupin e të drejtave dhe lirive më të rëndësishme njerëzore. Në këtë kategori hyjnë e drejta për punë dhe të drejtat lidhur me punën, të drejtat në rast të papunësisë, e drejta për grevë, e drejta për organizim sindikal. Jo rrallë, në disa kushtetuta shteti definohet si shtet social (shtet i drejtësisë sociale), ashtu që disa të drejta kushtetuese i përkasin temave me të cilat merret e drejta sociale. Të tilla janë: e drejta për sigurimin social, e drejta për mbrojtjen dhe ndihmën sociale, e drejta për pensionin familjar dhe të drejtat tjera si këto.

Degët e së drejtës që hyjnë në kategorinë e të **drejtës private** (civile), normojnë marrëdhëniet në mes të individëve dhe subjekteve të tjerë të së drejtës. Këta janë subjekte të barabartë. E drejta kushtetuese përmes burimit të saj më të rëndësishëm, kushtetutës, rregullon në parim vetëm disa çështje më të cilat merret e drejta civile, e drejta sendore dhe e drejta procedurale civile. Me kushtetutë rregullohet dhe mbrohet prona, regjimi dhe llojet e saj dhe marrëdhëniet pronësore, në nivel parimi. Me kushtetutë gjithashtu normohet regjimi juridik i tokës bujqësore dhe malore, pasuritë natyrore, bazat juridike të eksproprimit dhe nacionalizimit, pastaj të drejtat që kanë natyrë juridike civilo-procedurale, siç janë: e drejta për gjykim të drejtë e të paanshëm, për kompensim të dëmit, në paraqitjen e provave dhe kështu me radhë. E drejta e detyrimeve, si degë e së drejtës civile, një pjesë të parimeve të saj i ka në të drejtën kushtetuese, si p.sh.: parimi i lirisë së kontraktimit, epërsisë së vullnetit të palëve kontraktuese dhe i subsidiaritetit të ligjit.

E drejta ekonomike rregullon pozitën dhe veprimtarinë e subjekteve ekonomike. Disa nga parimet më të rëndësishme të së drejtës familjare kanë gjetur vendin e tyre në kushtetutë: liria e tregut, liria e organizimit ekonomik, liria e ndërmarrësisë.

Brenda të drejtës civile, **e drejta familjare** rregullon marrëdhëniet në mes të anëtarëve të familjes. Në kushtetuta ekzistojnë norma që në mënyrë të posaçme mbrojnë familjen, martesën, nënën, fëmijën, nxitet lindja, barazohen fëmijët martesorë dhe jashtëmartesorë, lejohet martesa dhe bashkësia e personave sipas orientimit të tyre seksual dhe kategori të ngjashme me këtë. **E drejta e trashëgimisë** normon bartjen në trashëgimtarë të të drejtave dhe detyrimeve në rast të vdekjes dhe situatave të tjera juridikisht të pranueshme. Në kushtetuta garantohet e drejta e trashëgimit, bartja e të drejtave pronësore përmes trashëgimit, e drejta e heqjes dorë nga trashëgimia etj.

5.3. Burimet e të drejtës kushtetuese

Burimet përbëhen nga kategori e materiale të ndryshme normative, që përbëhen nga akte e fakte përmes të cilave mund të gjurmohet dhe identifikohet origjina e normave juridike. Në këtë kuptim, si burime të së drejtës mund të konsiderohen dukuri të ndryshme, që kanë natyrën e akteve apo fakteve, që formojnë kriteret për gjurmimin dhe identifikim të tyre, siç janë me sa vijon:

- burimi i krijimit të së drejtës-kush është subjekti që krijon të drejtën (miratuesi i normës juridike);
- burimi i njohjes të së drejtës-në cilin akt gjendet e drejta dhe çfarë forme ka akti që përmban normat juridike dhe burimin e krijimit të tyre;
- procedura në të cilën krijohen normat juridike: juridiko-kushtetuese, ligjore apo procedura e krijimit të akteve nënligjore.

Krejt kjo si më sipër vlen edhe për burimet e të drejtës kushtetuese. Nuk ekziston asnjë civilizim në botë që nuk ka pasur apo nuk ka një sistem të vet të burimeve të së drejtës, që komandohet sipas pari-

meve të caktuara rregullative. Karakteristikë e të gjitha sistemeve juridike moderne është pluraliteti (shumësia) e burimeve të së drejtës. Fokusi ynë është vetëm në sistemin të cilit i takon **Kosova** – sistemi perëndimor **greko-romak** apo **judeo-kristian**.[211]

Si nocion gjuhësor, shprehja "burim i së drejtës" ka rrënjë latine, **fons juris.** Është farkëtuar nga juristët mesjetarë, për t'u bartur më pastaj në sistemet juridike moderne të vendeve të perëndimit dhe, nga to, tutje nëpër botë. Ideator i përdorimit të këtij koncepti është juristi gjerman **Fredrik Karl fon Savinji** (Friedrich Carl von Savigny: 1779-1961), i cili ka bërë dallimin në mes të origjinës ("Entstehungsgründe") të së drejtës dhe koncepteve e rregullave juridike që burojnë nga ajo. Origjina e të drejtës dhe konceptet e rregullat që burojnë nga ajo shkojnë dorë për dore në praktikën e përdorimit të së drejtës romake si burim për zgjidhjen e problemeve të kohës së shekullit XIX, kohë kur u krijua ky botëkuptim i Savinjit. Me "Entstehungsgründe" nënkuptohet lloji i tekstit në të cilin gjendet rregulla juridike, parimi apo koncepti juridik (kushtetutë, ligj, precedent etj).[212]

Në ndërkohë që shprehja "burim i së drejtës" përdoret në të gjitha sistemet juridike, kuptimi i saj nuk është i njëjtë, bile as brenda vetë sistemit të njëjtë juridik. Metafora që transmetohet përmes shprehjes "burim", e ka kuptimin e asaj që e drejta nuk lind vetvetiu, por "vjen", "rrjedhë", "buron", " shfaqet" etj., nga një vend i caktuar jashtë vetë asaj. Ai vend mund të jetë i vendosur në botën fizike (materiale), por edhe në botët metafizike (hyjnore, morale, etike etj.). Pa marrë parasysh nëse si metaforë ka ekzistuar në lashtësi, nuk diskutohet se ka pasur një prezencë të problemit të burimeve të së drejtës në përmbledhjen e **Justinianit,** si në **Digjesta** ashtu edhe në **Institucione**, për t'u bartur te civilistët dhe filozofët e së drejtës si një objekt studimi përgjatë tërë shekullit XVIII.[213] Përmes tyre, në fund, nga terreni i të drejtës civile burimet e së drejtës u bënë temë klasike e të drejtës kushtetuese.

Arsyet për këtë kapërcim transformues të burimeve të së drejtës nga terreni i të drejtës civile në objekt trajtimi në shkencën e të drejtës kushtetuese duhen kërkuar në **pozitivizmin gjerman** të fund-shekullit XIX, që shihte ligjin si shprehjen më sublime të vullnetit shtetëror, si dhe në teorinë e **Hans Kelsen** të dekadave të para të shekullit XX mbi kushtetutën si "normë mbi normimin". Pikëpamjet doktrinare të shek. XIX që bazoheshin mbi supremacinë (epërsinë) e ligjit kundrejt çdo burimi tjetër të së drejtës, në rend të parë kundrejt zakoneve, si dhe në dallimin në mes të legjislacionit dhe juridiksionit, kanë hapur rrugën për qartësimin e kuptimit të burimeve të së drejtës në botën bashkëkohore, diçka që ka ndodhur në pikëpamjet e **H. Kelsen** mbi teorinë e pastër të së drejtës që bazohet në normën fillestare ("grundnorm").

Dallimi standard i burimeve të së drejtës kushtetuese, ndërkaq, nis me dallimin në **burime materiale** dhe **burime formale**. Në **burimet materiale** të së drejtës kushtetuese hyjnë rrethanat shoqërore në të cilat krijohet (prodhohet) e drejta kushtetuese, si dhe forcat shoqërore që krijojnë (prodhojnë) atë. Sa i përket rrethanave shoqërore, një shoqëri duhet të jetë e pjekur politikisht, që nënkupton pjekurinë për arritjen e marrëveshjes në mes të forcave socio-politike, socio-ekonomike dhe socio-kulturore lidhur me vlerat më të çmuara që do të sanksionohen (bekohen) me kushtetutë, në mënyrë që ato të jenë në themel të së drejtës kushtetuese. Ato vlera në rend të parë kanë të bëjnë me jetën, lirinë

[211] Për një shtjellim të shkëlqyeshëm të burimeve të së drejtës në sistemet tjera juridike (në të drejtën arkaike, hindu, islamike etj.) cf. Roscoe Pound, "Sources and Forms of Law". *Notre Dame Lawyer,* Vol. 21 No. 4 (June 1946) fq. 247-314 në veçanti fq. 267-282.

[212] John Bell, "Sources of Law". *Cambridge Law Journal*, Vol. 77 No. 1 (March 2018) fq. 40–71 në fq. 42.

[213] **Digjestet** apo **Pandektet** ("Digesta seu Pandectae ") është kompliuar nga perandori **Justinian I** (Flavius Petrus Sabbatius Iustinianus: 482-565) në periudhën në mes të viteve 530-533 dhe përfaqëson njërin prej tri librave të **Kodit të Justinianit** ("Corpus Juris Civilis"), i bërë nga vitet 529-534. Dy të tjerat janë **Kodeksi** ("Codex"), që janë përmbledhja e ligjeve dhe akteve legjislative perandorake, dhe **Institutet** apo **Institucionet** ("Institute/Institutiones"), që paraqet një tekst për studentë ku përfshihen sqarimet konceptuale e terminologjike që nuk janë futur në dy librat tjera si më sipër. Vetë **Digjestet**/**Pandektet** përmban ekstrakte nga shkrimet e juristëve të njohur romak. Vetë **Justiniani**, më vonë, ka qenë i detyruar të nxjerrë ligje e akte të tjera juridike, sepse nuk ka mjaftuar ky kodifikim i tij, të cilat gjenden të përmbledhura në librin e katërt të **Kodit të Justinianit**, që njihet si **Novelat** ("Novela Constitutiones").

dhe drejtësinë. Në raste kur rrethanat shoqërore janë të pafavorshme, shoqëria është e përçarë dhe grupet shoqërore të armiqësuara në mes vete, nuk mund të krijohet kushtetuta, së paku jo në mënyrë demokratike.

Në **burime materiale** të së drejtës kushtetuese hyjnë aktet që kanë natyrë kryesisht politike, si:

- **kartat**;
- **deklaratat;** dhe
- **rezolutat**.

Kartat janë akte të shkruara që kryesisht kanë natyrë politike dhe nuk kanë formën e aktit juridik. Si të tilla, ato janë burim i të drejtës së disa degëve të tjera të së drejtës. Shikuar historikisht, kartat janë burim shumë i vjetër i të drejtës kushtetuese dhe rrjedhin nga konteksti socio-politik i konstitucionalizmit mesjetar. Në Angli, kartat e rëndësishme, që formojnë thelbin e të drejtës së saj kushtetuese, kanë emra të ndryshëm dhe kanë shërbyer si burim dhe inspirim i kushtetutave dhe të drejtave kushtetuese të vendeve të tjera. E kemi fjalën për **Kartën e Madhe të Lirive** ("Magna Carta Libertatum": 1215), **Peticioni mbi të Drejtat** ("Petition of Rights": 1628), **Habeas Corpus Act** (1679), si ligj mbi pacenueshmërinë e personalitetit, **Ligji mbi të Drejtat** ("Bill of Rights": 1689). Në territorin e ish-Jugosllavisë, Bosnje-Hercegovina e sotme ka histori të pasur me kartat: në vitin 1189, **Karta e Banit Kulin** i garantonte të drejtat tregtare dubrovnikasve.[214] Në planin ndërkombëtar, por që shërben si burim i të drejtës kushtetuese në shtete bashkëkohore, **Karta e Atlantikut** i ka parapri **Kartës së OKB**-së. Objekt i **Kartës së Atlantikut** kanë qenë marrëdhëniet ndërkombëtare pas **Luftës së Dytë Botërore**, që do të garantonin të drejtën e kombeve për vetëvendosje dhe mosnjohjen e ndryshimeve në sovranitetin territorial të shteteve të kryer me përdorim të forcës, tregtinë e lirë, lundrimin e lirë, globalizimin e tregtisë dhe, në fund, parimet e rregullimit kushtetues të shteteve të botës.

Edhe **deklaratat** janë akte të shkruara të natyrës politike, nuk kanë formën e aktit juridik, por që përfaqësojnë burim të së drejtës kushtetuese. Në këtë mes, më e njohura dhe më jetëgjata si burim i të drejtës kushtetuese është **Deklarata për të Drejtat e Liritë e Njeriut dhe Qytetarit**. Deklaratat miratohen nga organet përfaqësuese dhe me to rregullohet një çështje me shumë peshë politike.

Së fundi, **rezolutat** janë shumë të ngjashme me deklaratat. Përveç rregullimit të ndonjë çështje të rëndësishme politike, me to zakonisht urdhërohen organet e pushtetit ekzekutiv për një sjellje të caktuar apo ndërmarrjen e ndonjë veprimi në një mënyrë përkatëse. Të kësaj natyre janë, ta zëmë, rezolutat e **Kuvendit të Kosovës** lidhur me mënyrën e udhëheqjes së dialogut me **Serbinë**, që autorizojnë nënshkrimin e marrëveshjeve të caktuara nga neni 18.1 të Kushtetutës (ratifikimi i të cilave kërkon një shumicë të kualifikuar prej dy të tretave) etj.

Zakoni kushtetues është rregull kushtetuese e pashkruar që formohet në bazë të sjelljes së caktuar (**elementi i jashtë** apo **material i zakonisht kushtetues**) dhe mbi të cilin është krijuar bindja mbi detyrueshmërinë e tij juridike (**elementi i brendshëm** apo **psikologjik**). Zakoni kushtetues është burim plotësues i të drejtës kushtetuese. Përmes sjelljeve (veprimeve) të caktuara, që janë të njëjta si në situatat e mëhershme të ngjashme, që përbëjnë fizionominë e zakonit kushtetues, vjen deri te plotësimi i zbrazëtirave juridike apo eliminimi i paqartësive lidhur me rëndësinë dhe zbatimin e normës juridike. Këto janë dy funksionet themelore të zakonit kushtetues.

[214] Cf. më shumë në Josip Vrana, "Da li je sačuvan original isprave Kulina bana, Paleografijsko-jezična studija o primjercima isprave iz g. 1189". *Radovi Staroslavenskog Instituta,* Vol. 2 No. 2 (1955) fq. 5-57.

Sipas efektit që prodhojnë, ndërkaq, mund të dallohen tri lloje të zakoneve kushtetuese. Zakonet **secundum constitutionem** sqarojnë një normë të paqartë ose të papërcaktuar kushtetuese. Nevoja për këtë lloj të zakoneve kushtetuese krijohet nga vetë praktika dhe karakteri shumë abstrakt i normës kushtetuese. Me zakonet **praeter constitutionem** plotësohen zbrastirat kushtetuese. Këto zakone krijohen për arsye se me kushtetutë nuk mund të përcaktohet në tërësi dhe në mënyrë të përgjithshme rregullimi i krejt marrëdhënieve në mes të organeve shtetërore dhe në mes të shtetit dhe individit. Këto dy lloje të zakoneve janë të pranueshme sepse nuk anashkalojnë, por i plotësojnë normat kushtetuese. Zakonet **contra constitutionem** ndryshojnë kushtetutën për shkak se nuk zbatohet norma kushtetues, por norma zakonore. Këtu bëhet fjalë për dy norma kundërthënëse me njëra- tjetrën. Këto zakone nuk janë të pranueshme. Mënyra e vetme për zbatimin është të ndryshohet formalisht kushtetuta ekzistuese, ashtu që norma zakonore të shndërrohet (kthehet) në normë kushtetuese.

Britania e Madhe është shembull tipik i shtetit të pasur me zakone kushtetuese. Një rëndësi të posaçme kanë **konventat kushtetuese**, ndryshe të njohura edhe si zakone politike për shkak se krijohen për nevojat e praktikës politike. Ato paraqesin rregulla të mirësjelljes politike që zhvillohen nga praktikat kushtetuese, por nganjëherë krijohen me qëllim për të adresuar probleme politike të çastit por që ka gjasë të dukshme se do të riciklohen sërish në të ardhmen. Si të tilla, konventat kushtetuese nuk mund të zbatohen ligjërisht përmes rrugëve juridike, mirëpo cenimi (shkelja) e tyre tërheq me vete sanksionin politik. Për këtë arsye, konventat zbatohen dhe respektohen si rregulla kushtetuese të fuqisë më të lartë. Këto duhet të dallohen nga konventat kushtetuese që janë tubime formale të përfaqësuesve të popullit, në të cilat ushtrohet pushtetit konstituiv në emër të sovranit dhe në të cilat, shumë shpesh, vjen deri te miratimi i kushtetutës formale apo amendamentimi i kushtetutës ekzistuese. Si konventa kushtetuese në kuptimin e zakoneve kushtetuese me karakter politik, në kuptim të praktikës britanike dhe vendeve që modelohen sipas sistemit të saj kushtetues, konsiderohen, ta zëmë, praktika sipas së cilës kryeministri zgjidhet nga radha e anëtarëve të dhomës së ulët të Parlamentit britanik (nga vitit 1963), qeveria është kolektivisht përgjegjëse para dhomës së njëjtë, qeveria jep dorëheqje kur votohet me sukses mocioni i mosbesimit, monarku nuk refuzon shpalljen e ligjeve të miratuara në parlament, gjyqtarët nuk mund të jenë politikisht aktiv dhe kështu me radhë.

Burime formale të së drejtës kushtetuese konsiderohen aktet e përgjithshme juridike që përmbajnë norma që rregullojnë çështje nga materia kushtetuese. Burim themelor formal i të drejtës kushtetuese është kushtetuta. Në ndërkohë që krejt burimet tjera mund të quhet burime plotësuese. Me kategorinë e fundit nënkuptohen dispozitat që kanë fuqi më të ulët kushtetuese dhe janë: ligjet (ligjet kushtetuese, ligjet organike, ligjet e zakonshme dhe dekret – ligjet), rregulloret dhe aktet tjera të përgjithshme të ekzekutivit, rregulloret e parlamentit dhe dispozita të tjera nënligjore.

Kushtetuta është burimi themelor dhe më i rëndësishëm i të drejtës kushtetuese në shtet. Burim i të drejtës kushtetuese janë edhe kushtetutat e njësive federale në federatë. Kur ligji kushtetues ka fuqi kushtetuese, atëherë ai është burim themelor i të drejtës kushtetuese. Fuqi kushtetuese kanë edhe amendamentet kushtetuese dhe anekset kushtetuese (aty ku kushtetutat përmbajnë ankese dhe shtojca të tjera). Disa shtete njohin kategorinë juridike të ligjeve kushtetuese për zbatim të kushtetutës (Sllovenia, Maqedonia dhe Mali i Zi). Këto ligje, në të vërtetë, rregullojnë materien e dispozitave kalimtare dhe të fundit të kushtetutës (afatet dhe kushtet për kalim në sistemin e ri kushtetues dhe fati i dispozitave dhe kategorive kushtetuese të sistemit të vjetër). Pa marrë parasysh arsyet e miratimit të tyre, ligjet në fjalë miratohen përnjëherë me kushtetutën dhe kanë fuqi më të lartë se ligji i zakonshëm. Në rastet kur miratimi i tyre bëhet sipas procedurës që vlen për kushtetutën, atëherë kanë fuqi të njëjtë juridike si kushtetuta.

Kushtetuta qëndron në majën më të lartë nga të gjitha burimet e të drejtës kushtetuese. Kushtetuta është një akt i shkruar, sipas rregullit i kodifikuar (në një tekst unik). Ka raste kur ajo nuk haset në një dokument të vetëm të shkruar dhe të kodifikuar, por në disa sosh. Në një rast të tillë, aktet e tilla

kushtetuese, të shkapërderdhura në disa akte, kanë fuqinë më të lartë se ligjet. Edhe në mes tyre, megjithatë, mund të ekzistojnë akte me fuqi më të ultë juridike kundrejt akteve të tjera kushtetuese. Kështu, ta zëmë, në **Suedi** fuqinë juridiko-kushtetuese kanë Instrumenti i qeverisjes, Ligji mbi trashëgiminë e kurorës, Ligji mbi lirinë e shtypit dhe Ligji mbi lirinë e shprehjes, kurse kushtetutë konsiderohet edhe akti i pestë, Ligji mbi parlamentin, i cili ka fuqi më të ulët juridike se katër aktet e para, por më të lartë se ligjet e zakonshme.[215] Ekzistojnë edhe rastet e kundërta me këtë, përkatësisht situata kur ekzistojnë disa akte kushtetuese që kanë fuqinë e ligjit mirëpo konsiderohen si kushtetutë. I tillë është rasti, ta zëmë, me **Izraelin**, ku ekzistojnë një mori ligjesh themelore (emri tyre zyrtar: "Basic Laws") që konsiderohen kushtetutë e pakodifikuar, e përbërë nga pesëmbëdhjetë akte kushtetuese (deri në momentin që po shkruhen këta rreshta: shkurt 2022) dhe që formalisht kanë fuqinë e ligjeve. Bëhet fjalë për ligjet themelore që kanë të bëjnë me sa vijon: territorin dhe pasurinë shtetërore, qeverinë, ushtrinë, Jerusalemin, të drejtat e njeriut, referendumin dhe kështu me radhë. Krahas situatave si më sipër, një rast i posaçëm është kur ekziston kushtetuta e kodifikuar dhe krahas saj edhe një akt kushtetues që ka fuqi kushtetuese. I tillë është rasti, ta zëmë, me **Danimarkën** që ka edhe Ligjin mbi trashëgiminë e kurorës.[216]

Normat kushtetuese kanë fuqinë e njëjtë dhe njëkohësisht më të lartë juridike. Me rastin e interpretimit të tyre për qëllime të zbatimit në praktikë (nga ana e gjykatave kushtetuese apo gjykatave të tjera që ushtrojnë juridiksion kushtetues), atëherë vjen deri te përcaktimi i kuptimit të saktë dhe konkret i dispozitave të përgjithshme (abstrakte) kushtetuese. Në këtë mënyrë vjen deri të shfrytëzimi i parimeve të caktuara kushtetuese me rastin e interpretimit për qëllimet e zbatimit të normave kushtetuese në raste konkrete jetësore. Gjurmët e idesë sipas së cilës normat kushtetuese nuk kanë fuqinë e njëjtë juridike e gjejmë te konstitucionalisti **Karl Shmit**, i cili, duke iu referuar **Kushtetutës së Vajmarit** (1919), në veprën e tij monumentale, botuar në mes të dy luftërave botërore, konstatoi se ekzistonin disa dispozita që nuk mund të amendamentoheshin asnjëherë, sepse përbënin bërthamën e identitetit të shtetit. Sipas tij, dispozita të tilla ishin ato që rregullonin formën e shtetit dhe formën e qeverisjes.[217] Kjo

---

215 Cf. **Sweden's Constitution of 1974 with Amendments through 2012**. Në internet: https://www.constituteproject.org/ constitution/Sweden_2012.pdf?lang=en (shikuar në shkurt 2022).

216 Cf. **Denmark's Constitution of 1953.** Në internet:https://www.constituteproject.org/constitution/ Denmark _ 1953. pdf?lang=en (shikuar në shkurt 2022); **The Act of Succession of March 27, 1953, amended on June 12th, 2009**. Në internet: https://english.stm.dk/media/8875/the-act-of-succession-of-march-27.pdf (shikuar në shkurt 2022).

217 **K. Shmit** ka bërë dallimin, sikundër dihet, në mes të drejtës kushtetuese dhe kushtetutës. Më këtë të fundit ka nënkuptuar vendimet fundamentale politike lidhur me formën e organizimit të shtetit, vendime që kanë **karakter ekzistencial** dhe nuk i nënshtrohen procedurave të amendamentimit/rishikimit kushtetues. Këto procedura vlejnë vetëm për atë që ky autor e cilëson si e drejtë kushtetuese. Me të drejtë kushtetuese nënkuptohet e drejta kushtetuese pozitive që bazohet në një kushtetutë të shkruar që kodifikon një materie kushtetuese dhe që ka procedura për miratim dhe amendamentim/rishikim të vetëvetes. Gjithnjë sipas tij, preambulat përfaqësojnë pikërisht vendimet politike fundamentale: ato nuk janë vetëm deklarata të thjeshta, por vendime substanciale me natyrë ekzistenciale, të cilat nuk mund të ndryshohen përmes procedurave të amendamentimit/rishikimit kushtetues; për ndryshimin apo eliminimin e tyre duhet vendim konkret politik, i ri, që definon formën e ekzistencës politike të një populli. Kjo është kështu për shkak se preambulat përfaqësojnë vendime mbi formën dhe përmbajtjen e ekzistencës politike të një populli. Kështu ta zëmë, pohon **K. Shmit**, vendimi për të qenë republikë apo monarki, republikë sovjetike apo diçka tjetër nuk është çështje e të drejtës kushtetuese pozitive por objekt (substancë) e një vendimi konkret politik lidhur me formën e ekzistencës politike të një populli. Cf. Carl Schmitt, *Constitutional Theory*, fq. 77-80. Cf. edhe Enver Hasani, *E DREJTA KUSHTETUESE. Studim kritik mbi librin"E drejta kushtetuese" të autorëve A. Bajrami e F. Muçaj* (Jalifat Publishing: Hjuston, Teksas, SHBA, 2018) fq. 47-48 & 63-65 (në kontekstin e parimeve themelore kushtetuese dhe identitetit kushtetues); 58-59, 71, 79 (mbi dallimin në mes të kushtetutës dhe të drejtës kushtetuese te **K. Shmit**), 111-112 (në kontekstin e "klauzolave të përjetësisë", si dispozita kushtetuese që përjetësojnë disa parime dhe vlera kushtetuese përgjithmonë, duke i nxjerrur nga e drejta për amendamentim, si dhe në kuadër të diskutimit të doktrinës mbi "amendamentet kushtetuese kundërkushtetuese" në **LTH** dhe origjinën e tij shmitiane).Njëjtë vlen edhe për **Kosovën** dhe për çdo shtet tjetër: vendimi nëse **Kosova** do të bashkohet me Shqipërinë ose më ndonjë shtet tjetër, nëse do të bëhet monarki apo federatë, nuk i takon procedurës për amendamenim nga neni 144 ["Amendamentimi] i Kushtetutës. Këto janë vendime politike konkrete që kryhen dhe zhvillohen jashtë kuadrit aktual kushtetues. Kur ndodhë kjo, atëherë ato vendime politike për të ardhmën formojnë përmbajtjen (substancën) e një preambule të re të një kushtetutë të re

praktikë më vonë u njoh si doktrina mbi **amendamentet kushtetuese kundërkushtetuese** ("unconstitutional constitutional amendements") dhe u sanksionua në **Gjermani** me **LTH**.[218] **Kosova** dhe disa nga vendet përreth kanë dispozita që ngjasojnë me doktrinën e amendamenteve kushtetuese kundërkushtetuese. Dallimi në mes të tyre ekziston se, në rastin e Kosovës dhe vendeve përreth saj, disa dispozita mund të ndryshohen vetëm nëse plotësohen kushtet e caktuara (materiale dhe procedurale), kurse në rastin e doktrinës në fjalë disa dispozita kushtetuese fare nuk mund të ndryshohen, pra nuk mund të jenë objekt amendamentimi. Pikërisht për këtë arsye edhe quhen amendamente kushtetuese kundërkushtetuese. Në dy raste, megjithatë, qëllimi ngelet i njëjtë: kushtetutëbërësi nacional synon që disa dispozita kushtetuese të konsiderohen si komanduese dhe me fuqi më të lartë juridike se dispozitat tjera të aktit themelor të shtetit.

Në **Kosovë**, dispozitat që komandojnë dispozitat tjera kushtetuese ankorohen në kapitullin e dytë të Kushtetutës që normon liritë dhe të drejtat e njeriut, ku përcaktohet se ndryshimet"[...] mund të miratohen nga Kuvendi vetëm pasi të ketë adresuar Kryetari i Kuvendit të Kosovës amendamentin e propozuar në Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar paraprakisht nëse ndryshimi i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës (neni 144.3 i Kushtetutës). Sipas jurisprudencës së **Gjykatës Kushtetuese**, kjo përfshinë edhe kapitullin e tretë të Kushtetutës, që ka të bëjë me liritë dhe të drejtat e komuniteteve. Kjo është krejt e natyrshme, meqë kapitulli i tretë nuk është asgjë tjetër pos një zgjerim dhe përplotësim i kapitullit të dytë dhe lirive e të drejtave të garantuara me të. Kjo nënkupton se çdo herë kur paraqiten amendamente kushtetuese që bien ndesh me kapitullin e dytë dhe të tretë, atëherë bëhet fjalë për amendamente kushtetuese kundërkushtetuese, që nuk mund të kalojnë për miratim në Kuvendin e Kosovës. I tillë ka qenë rasti me amendamentet që njihet me emrin "rasti Jahjaga" (sipas emrit të ish-Presidentes së Kosovës, Atifete Jahjaga, 2011-2016). Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese anuloi mbi 60 % të draft-amendamenteve kushtetuese si kundërkushtetuese ngaqë pakësonin liritë dhe të drejtat nga kapitulli i dytë i Kushtetutës.[219]

Në nenin 177 të **Kushtetutës së Shqipërisë**, kapitulli i shtatëmbëdhjetë që flet për rishikimin kushtetues, nuk normohet çështja e dispozitave që nuk mund të amendamnetohen fare ose që mund të amendamentohen por me një procedurë të vështirësuar. Kjo nënkupton se në Shqipëri nuk është e zhvilluar e drejta pozitive kushtetuese sa i përket amendamenteve jokushtetuese. Ky nen rregullon standardin e pamundësisë absolute të rishikimit kushtetues në kohën e gjendjes së jashtëzakonshme (paragrafi dytë) si dhe standardin e pamundësisë relative të rishikimit kushtetues në rast të dështimit të përpjekjes për rishikim (paragrafi tetë).

Te nenet 129-131 të kreut të tetë të **Kushtetutës së Maqedonisë së Veriut**, gjendja paraqitet pak më ndryshe se në Shqipëri. Kjo sepse, për dallim nga Shqipëria, këtu as që vihen pengesa procedurale për rinisjen e amendamentimit pas dështimit të fundit për amendamentim. Krejt çfarë thuhet është se amendamentimi bëhet më një shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

---

të Kosovës: aty mund të konstatohet se vendi ynë është monarki, shtet federal, shtet i asocuar më një shtet tjetër dhe kështu me radhë. Nëse ndodhë kjo, atëherë nuk bëhet fjalë për procedura sipas nenit 144 të Kushtetutës por për vendime konkrete politike lidhur me ndyrshimin e formës së ekzistëncës politike aktuale të Kosovës.

218 Cf. më shumë për doktrinën e **amendamenteve kushtetuese jokushtetuese** në Yaniv Roznai, "Unconstitutional Constitutional Amendments – The Migration and Success of a Constitutional Idea " 61(3) *American Journal of Comparative Law* Vol. 61 No. 3 (2013), fq. 657-719; Yaniv Roznai, *Unconstitutional Constitutional Amendments: A Study of the Nature and Limits of Constitutional Amendment Powers*. **A thesis submitted to the Department of Law of the London School of Economics for the degree of Doctor of Philosophy** (The London School of Economics and Political Science: London, February 2014). Në internet: http://etheses.lse.ac.uk/915/ (shikuar në mars 2022); Silvia Suetu, *Eternity Clauses in Democratic Constitutionalism* (Oxford University Press: Oxford, 2021).

219 *Rastet K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12. Amendamentet e propozuara kushtetuese, të dorezuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës me 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr. Ref.:AGJ 284/12. Prishtinë, me 20 korrik 2012.

Zgjidhjet kushtetuese në **Mal të Zi** janë më kolorite, ani se as këtu nuk ekzistojnë dispozita që shprehimisht nxjerrin jashtë procesit amendamentues pjesë apo dispozita të caktuara kushtetuese. Në të shumtën e rasteve zgjidhjet kushtetuese kanë të bëjnë me pengesa procedurale për amendamentim kushtetuese, që nuk mund të ndodhë një vit pas dështimit të fundit (paragrafi i pestë i nenit 155 të Kushtetutës), si dhe gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme (paragrafi shtatë i nenit 156 të Kushtetutës), dhe shumë më pak me pengesa materiale (substanciale) për amendamentim. Situatat e fundit kanë të bëjnë me dispozita të caktuara kushtetuese, të numëruara në mënyrë specifike në nenet 1 ("Shteti"), 2 ("Sovraniteti"), 3 ("Territori shtetëror"), 4 ("Simbolet shtetërore"), 12 ("Shtetësia malazeze"), 13 ("Gjuha dhe shkrimi"),15 ("Marrëdhëniet me shtete dhe organizatat tjera"), 45 ("E drejta e votës") dhe 157 ("Konfirmimi në referendum") të **Kushtetutës së Malit të Zi**, të cilat, sipas nenit të saj 157, mund të amendamentohen vetëm nëse për to votojnë tri të pestat e krejt votuesve në **Mal të Zi**.

As në **Serbi** nuk ekzistojnë dispozita të paamendamentueshme: Kushtetuta, në pjesën e nëntë ("Ndryshimi Kushtetutës"), nenet 203-205, rregullon materien e amendamentimit, kryesisht duke vënë pengesa procedurale. Në rend të parë, aty përcaktohet se nuk mund të nis procedura e amendamnetimit për një vit pas dështimit të fundit për amendamentim. Një pengesë tjetër procedurale është ajo që ka të bëjë me luftën dhe gjendjen e jashtëzakonshme, situata në të cilat kurrë nuk mund të vjen deri te ndryshimi i Kushtetutës (neni 204). Në fund fare vijnë pengesat që kanë të bëjnë me preambulën, parimet themelore, të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, organizimin e pushtetit, shpalljen e gjendjes së luftës dhe gjendjes së jashtëzakonshme, shmangien nga liritë dhe të drejtat e njeriut në gjendje të luftës dhe gjatë gjendjes së jashtëzakonshme dhe, në fund, procedurën për ndryshim të Kushtetutës. Në këto raste nuk mjafton vota e dy të tretave të krejt deputetëve të **Kuvendit të Serbisë**, siç kërkohen të paragrafin e dytë të nenit 2003 të Kushtetutës, por duhet patjetër të vërtetohet (ratifikohet) përmes referendumit, ndryshimi që ka të bëjë çështjet si më sipër (paragrafi gjashtë i nenit 2003). Në Preambulë, sikundër dihet, gjendet edhe zotimi serb për tërësinë territoriale të Serbisë, me Kosovën brenda (të cilën e quajnë me emrin mesjetar kishtar "Kosova dhe Metohija").

Sikundër shihet dallimet ekzistojnë edhe sa i përket fuqisë së normave kushtetuese që lidhen me procedurën e ndryshimit të kushtetutës. Kështu është edhe gjetiu nëpër botë: në disa kushtetuta procedura për ndryshim të pjesëve të caktuara kërkon një shumicë të kualifikuar, kurse për pjesët tjera nuk kërkohet një gjë e tillë. Ka raste kur çdo ndryshim kushtetues duhet të ratifikohet me referendum. Në fakt, këtu bëhet fjalë për pengesa procedurale për ndryshim të kushtetutës, që shërbejnë si një pikë referimi për dallim të gjendjes kushtetuese nga situatat jokushtetuese që mund të krijohen me miratim të amendamenteve në kushtetutën e parë. Këtu bëhet fjalë për një **standard procedural** mjaft të përhapur ndër kushtetutat bashkëkohore. Për vendet përreth **Kosovës** u pa nga më sipër, kurse në **Kosovë** ato dispozita procedurale janë të vendosura në nënin 144.2 të Kushtetutës, ku përcaktohet se "[...] Çdo ndryshim do të kërkojë miratimin e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës".

Shtjellimi ynë deri këtu tregon se, sidoqoftë, vetëm **Kosova** ka sanksionuar doktrinën mbi **amendamentet kushtetuese kundërkushtetuese**, kurse vendet tjera përreth saj më shumë përcaktojnë pengesa procedurale që vështirësojnë amendamentimin. Sa i përket ndryshimit të kushtetutës gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, luftës dhe në rrethana të tjera jonormale, ato në të vërtetë nuk i takojnë botës së **amendamenteve kushtetuese kundërkushtetuese.** Në këto situata, më shumë bëhet fjalë për ndalesë absolute të ndryshimit të kushtetutës, në tërësi ose pjesërisht, gjatë kohës sa zgjatë lufta apo rrethanat e jashtëzakonshme. Edhe në rastin e Kosovës, duhet vënë në dukje se ndalesa është relative, përkatësisht se amendamentet fare nuk mund të kalojnë nëse pakësojnë të drejtat e liritë nga kapitujt dy dhe tre të Kushtetutës. Në vendet tjera, ndërkaq, amendamentet kushtetuese kundërkushtetuese ekzistojnë dhe kanë karakter absolut: disa dispozita kushtetuese janë tërësisht të përjashtuara nga mundësia e amendamentimit. Këto janë, në thelb, sipas kuptimit të plotë të fjalës, zgjidhjet kushtetuese që përfaqësojnë doktrinën mbi **amendamentet kushtetuese jokushtetuese**.

Së fundi, ekzistojnë kushtetuta që vetëvetes ia kanë dhënë të drejtën e rregullimit ekskluziv të disa çështjeve, duke përjashtuar çdo akt tjetër nga normimi i tyre. Këto mund të cilësohen si **rezervate kushtetuese**, siç janë, ta zëmë, dispozitat kushtetuese që theksojnë se juridiksioni dhe kompetenca e gjykatës kushtetuese mund të caktohet vetëm me kushtetutë, gjyqtar mund të zgjidhet vetëm ajo/ai që plotëson kushtet e përcaktuara me kushtetutë dhe kështu me radhë.

Amendamentet kushtetuese plotësojnë dhe zhvillojnë parimet dhe dispozitat tjera të kushtetutës dhe, më rrallë, norma ekzistuese kushtetuese zëvendësohet me të renë. Në diskursin kushtetues kjo fjalë ka ardhur, rrjedhur nga gjuha frënge (me rrënjë latine) dhe ka kuptimin e korrigjimit (përmirësimit) të një ligji apo aktgjykimi. Kuptimi i amendamenteve konsiston në atë që kushtetuta të përshtatet ndaj rrethanave dhe nevojave të ndryshuara shoqërore, të bëhet më e mirë dhe përjetësisht e qëndrueshme (kushtetutat që kanë mbijetuar ndër shekuj janë kushtetutat e SHBA-së, Holandës, Belgjikës, Australisë etj.). Në këtë drejtim, amendamentet kanë suksese të ndryshme. Kështu, ta zëmë, Kushtetuta e parë e Belgjikës (1831) ka mund të ngelë në fuqi gati për dy shekuj, pikërisht për shkak të një sërë amendamentesh (58 deri në vitin 2012), kurse Kushtetutat e ish-Jugosllavisë të vitit 1963 dhe 1974 kanë pasur jetë të shkurtër, përkundër një numri mjaft të madh të amendamenteve (42 dhe 48 respektivisht). Në kushtetutën më të vjetër në botë, Kushtetutën e SHBA-së, janë vënë 27 amendamente (të fundit në vitin 1992). Procedura e miratimit të amendamenteve, në parim, është e njëjtë me procedurën e miratimit të kushtetutës. Nga kjo rrjedh se amendamentet kushtetuese kanë fuqinë kushtetuese të njëjtë me kushtetutën ekzistuese të cilën e amendamentojnë dhe, në aspektin formal, janë burim formal i të drejtës kushtetuese baras me kushtetutën. Fakti që në disa vende, përfshirë **Kosovën**, ekziston juridiksioni i gjykatës kushtetuese për vlerësim të kushtetutshmëirsë së amendamenteve të propozuara nuk nënkupton që amendamentet kanë fuqi më të ulët juridike se kushtetuta ekzistuese. E njëjta vlen, **mutatis mutandis**, edhe për rastet kur në disa kushtetuta bëhet dallimi në mes të procedurës së amendamentimit dhe rishikimit (revizionit) kushtetues: në dy rastet bëhet fjalë për ndryshime kushtetuese. Sipas rregullit, caqet e këtij ndryshimi janë më të thella dhe më radikale te rasti i rishikimit. Për këtë arsye edhe bëhet dallimi në mes të **rishikimit të pjesshëm** dhe **rishikimit total** (si p.sh. **Austria**, **Bullgaria**, **Kostarika**, **Spanja**, **Zvicra**). Kjo, megjithatë, nuk nënkupton se, pas miratimit të tyre, amendamentet dhe dispozitat kushtetuese të prodhuara pas rishikimit kanë fuqi më të ulët juridike se kushtetuta ekzistuese. Nga kushtetuta ekzistuese, në rastin e rishikimit të tërësishëm, mund të ngelin vetëm dispozitat kushtetuese mbi procedurën e rishikimit të tillë. Kur ngelin, atëherë ato kanë fuqinë e njëjtë me dispozitat e reja kushtetuese. Kur nuk ngelin, pra kur ndryshon edhe procedura e rishikimit për të ardhmen, sërish mund të lind një kushtetutë tërësisht të re, që ka lindur sipas procedurës kushtetuese dhe në vijim të ushtrimit të **pushtetit konstituiv derivativ**. Kur ky nuk është rasti, pra kur nuk ndryshojnë pjesët tjera operative dhe koncepti i kushtetutës, por vetëm procedura dhe kushtet e ndryshimit të saj, atëherë bëhet fjalë për amendamentim apo rishikim të pjesshëm. Në rastet kur kushtetuta e re lind **ab nihilo** me rrugë **extra constitutionem**, atëherë gjendemi në terrenin e ushtrimit të **pushtetit konstituiv origjiner** ("pouvoir constituant originaire"), jo në atë të rishikimit kushtetues.[220] Dallimi i vetëm mes amendamenteve dhe dispozitave kushtetuese pas prodhimit të tyre, ka të bëjë me situatat e "klauzolave të përjetësisë" apo **dispozitat e paamendamentueshme kushtetuese**. Këto klauzola kanë fuqi sipërore kundrejt të tjerave sepse ndryshimi dhe abrogimi i tyre nuk mund të bëhet në asnjë situatë dhe sipas asnjë procedure. Kjo në veçanti vjen në shprehje në vendet pas konfliktit, në të cilat këto klauzola kanë një funksion dhe natyrë tjetër: **klauzolat e përjetësisë** në kontekstin e kushtetutave pas konfliktit, përfshirë rastin e **Kosovës**, në vetvete janë instrument i negocimit dhe zgjidhjes së konfliktit dhe mishërojnë thelbin e marrëveshjes politike që ka lehtësuar miratimin e krejt kushtetutës.[221] Këto **klauzola** nuk janë asgjë tjetër pos substanca (esenca) e vetë doktrinës mbi **amendamentet kushtetuese kundërkushtetuese** dhe vetë arsyeja e lindjes dhe ekzistimit të kësaj doktrine.

[220] Cf. më shumë për këtë në Enver Hasani, *E DREJTA KUSHTETUESE. Studim kritik mbi librin "E drejta kushtetuese" të autorëve A. Bajrami e F. Muçaj*, fq. 110-117.

[221] Silvia Suteu, *Eternity Clauses in Democratic Constitutionalism* (Oxford University Press: Oxford, 2021) fq. 61-62.

Amendamentet kushtetuese miratohen pas kushtetutës. Shpeshtësia e prodhimit të tyre diktohet nga nevojat e shoqërisë dhe rrethanat politike (konsensusi i gjerë shoqëror, intensiteti i mosmarrëveshjeve dhe konfliktit politik në mes të grupeve shoqërore etj.). Në këtë kuptim, njihen **dy teknika të amendamentimit**. Sipas teknikës së parë, nuk ndryshohet teksti bazë i kushtetutës, por amendamentet kushtetuese shtohen në fund të kushtetutës, si plotësim i saj. Në këto zgjidhje kushtetuese, me rastin e interpretimit dhe zbatimit të dispozitës konkrete kushtetuese që është amendamentuar, domosdo duhet të merret parasysh teksti fillestar i kushtetutës dhe vetë amendamenti. Krejt ndryshe paraqitet situata kur zgjidhja kushtetuese ka të bëjë me teknikën e dytë, pra kur me amendament fshihet një dispozitë e hershme e kushtetutës dhe më nuk vlen, kurse në vend të saj vjen amendamenti. Sipas kësaj teknike, çdo amendament shkakton rinovimin (përtëritjen) e kushtetutës dhe krijimin e një teksti tjetër të saj, të spastruar. Një lloj i veçantë i amendamenteve janë ato që nuk përmbajnë rregull të re të sjelljes, por vetëm fshijnë normën ekzistuese. Vlen të theksohet se amendamenti mund të miratohet edhe për të plotësuar një **zbrazëtirë juridike**.

Shtojcat dhe **anekset** janë burime të së drejtës kushtetuese në disa shtete. Kanë fuqi kushtetuese, miratohen së bashku me kushtetutën dhe janë të sistematizuara në një tërësi të posaçme, krejt kjo me qëllim të zvogëlimit të vëllimit të tekstit të kushtetutës bazike. **Kushtetuta e Indisë** (1949) përfaqëson shembullin tipik të këtij lloji të kushtetutave, sepse në kohën e miratimit ka pasur tetë shtojca (schedule). Kështu, ta zëmë, në shtojcën e parë vihen në dukje shtetet anëtare, njësitë federale dhe territoret e tyre, në të dytën përcaktohen pagat dhe privilegjet e funksionarëve të lartë shtetërorë, në të tretën rregullohet betimi dhe deklaratat solemne të funksionarëve të lartë shtetërorë dhe kështu me radhë. Pesë shtojca, megjithatë, janë miratuar më pastaj, pas miratimit të kushtetutës bazë, ashtu që sot janë gjithsejtë dymbëdhjetë sosh.[222] Përveç Indisë, edhe kushtetutat e disa vendeve të tjera që i përkasin **Komonueltit Britanik** (ish-kolonitë britanike) përmbajnë shtojca dhe anekse, të draftuara dhe miratuara me të njëjtin qëllim sikur në rastin indian. Ka raste kur vetë kushtetuta është **aneks** i një dokumenti tjetër, pra një situatë krejt e kundërt me këtë si më sipër, siç është rasti me **Kushtetutën e Bosnje – Hercegovinës**, e cila është pjesë e **Marrëveshjes së Dejtonit** dhe ka hy në fuqi së bashku me te.

Ligji kushtetues është burim formal i të drejtës kushtetuese dhe nën këtë emër mund të futen dhe zakonisht futen akte të ndryshme juridike. Ligji kushtetues është sikur kushtetuta, akt me fuqi juridike kushtetuese. Kur me të ndryshohet ose plotësohet kushtetuta, atëherë ai ka fuqi juridiko-kushtetuese. Në rastet kur nuk ndryshojnë ose plotësojnë kushtetutën, statusi dhe fuqia juridike e ligjit kushtetues ndryshon. Për këtë arsye, ai mund të futet në kategorinë e burimeve të së drejtës që kanë fuqinë juridike ndërmjet kushtetutës dhe ligjit të zakonshëm dhe ka disa forma të manifestimit. Forma e parë është kur ligji kushtetues shënon aktin më të lartë juridik të njësisë federale apo autonomisë territoriale. Tjetër formë, e dyta, është kur ligjet që rregullojnë materien kushtetuese, siç janë, ta zëmë, zgjedhjet dhe materia e lirive dhe të drejtave të njeriut e të qytetarit, mbajnë emrin e ligjit kushtetues dhe, sipas fuqisë juridike, qëndrojnë mbi ligje të zakonshme, por nën kushtetutë. Në këtë kuptim, ligjet e tilla mund të cilësohen edhe si **ligje organike**, ani pse e kanë emërtimin e **ligjit kushtetues** (në mes të ligjit dhe kushtetutës). Në rastet kur ligji kushtetues ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e kushtetutës ekzistuese, atëherë ai është pjesë përbërëse e saj. Kur ky nuk është rasti, atëherë ligjet e tilla nuk mund të jenë kushtetuese, ani pse mund te kenë një cilësim të tille. Këtë e ka konstatuar me shumë të drejtë **Gjykata Kushtetuese e Kroacisë** (GJKKro) në një vendim të saj që thotë se ligjet që rregullojnë mbrojtjen e komuniteteve nacionale, bashkëpunimin e Kroacisë me Gjykatën e Hagës për ish-Jugosllavi si dhe ligji për situatat kur presidenti nuk mund të veprojë për arsye objektive janë ligje organike, jo ligje kushtetuese siç thuhet në emërtimet e tyre.[223] Me këtë vendim, kjo gjykatë e ka bërë të qartë se në rastin

[222] **The Constitution of India** [As on 9 th September 2020]. Në internet: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/viewer.html?pdfurl=https%3A%2F%2Flegislative.gov.in%2Fsites%2Fdefault%2Ffiles%2FCOI.pdf&clen=2780324&chunk=true (shikuar në mars 2022).

[223] Smiljko Sokol, *Ustavno pravo* (Narodne novine: Zagreb, 2009) fq. 17-18. Pjesa me titull"Ustavni pravo kao grana prava i njegovi izvori "diskuton këto çështje dhe këto dallime në sistemin kushtetues kroat, duke iu referuar

e ligjeve kushtetuese, materia kushtetuese është përcaktues parësor: me ligje kushtetuese, zakonisht në mënyrë të drejtpërdrejt ndryshohet dhe plotësohet kushtetuta ekzistuese, përveç ligjeve kushtetuese që nuk i takojnë kësaj kategorie, siç u përcaktua më sipër, kurse me ligje organike nënkuptohet lloji i veçantë i ligjeve të cilat përmbajnë rregullat fundamentale kushtetuese mbi organizimin e pushtetit shtetëror dhe mbi liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve. Me këto ligje, thënë ndryshe, nuk ndryshohet dhe plotësohet kushtetuta, as nuk krijohen për zbatim të kushtetutës, por caktohen rregullat fundamentale kushtetuese mbi organizimin e pushtetit shtetëror dhe mbi vendin dhe pozitën e individëve dhe komuniteteve pakicë në sistemin kushtetues. Me ligje organike jo domosdo normohet materia kushtetuese: disa ligje kushtetuese janë edhe ligje organike, mirëpo, anasjelltas ky çdo herë nuk është rasti, sepse mund të ketë ligje që janë kushtetuese e që nuk cilësohen si ligje organike. Fare në fund, lloj i veçantë i ligjit kushtetues është ligji mbi zbatimin e kushtetutës, i cili, zakonisht, ka fuqinë më të lartë se ligji, nganjëherë edhe fuqinë e njëjtë me kushtetutën. [224]

Kategoria e ligjeve organike për herë të parë është përmendur në **Francë** në **Republikën e Dytë** (1848), për t'u bërë standard me **Kushtetutën e Republikës së Katërt** (1946-1958). Me vonë, liritë dhe të drejtat e njeriut, kryesisht ato që kanë të bëjnë me komunitetet pakicë, u bënë pjesë normative e kushtetutave nacionale, krahas normave mbi rregullimin e shtetit si një strukturë organike me subjektivitet të ndarë nga ata që punojnë në të dhe për të. Pas kësaj kohe ka nisur historia e kushtetutave që kanë futur ligjet organike për të normuar në mënyrë fundamentale edhe liritë dhe të drejtat e njeriut, krahas organizimit te pushtetit publik. I tillë është rasti me **Spanjën** dhe **Kroacinë.** Ky autorizim për nxjerrjen e këtij lloji të ligjeve, me një shumicë të kualifikuar dhe me një procedurë të posaçme, buron nga kushtetuta dhe atë në mënyrë shprehimore. Pa pasur dispozita kushtetuese që në mënyrë shprehimore përcaktojnë materien që duhet të mbulohet me ligje organike nuk mund të ketë ligje të tilla, pa marrë parasysh se disa nga to mund të nxirren më shumicë të kualifikuar dhe me procedurë të posaçme dhe të vështirësuar. Është kushtetuta nacionale, me fjalë të tjera, ajo që autorizon nxjerrjen e ligjeve organike dhe definon materien të cilën e mbulojnë ligjet e tilla. Kështu është në **Francë**, **Kroaci**, **Spanjë, SHBA** dhe në shumë vende të tjera të botës (në veçanti ato që modelohen sipas sistemit francez, ku edhe ka lindur koncepti i ligjeve organike).[225]

Në asnjërin prej vendeve fqinje me **Kosovën** nuk përcaktohet me kushtetutë kategoria e **ligjeve organike** në kuptimin e plotë të fjalës siç u përshkrua këtu. **Kosova** nuk bënë përjashtim në këtë drejtim: ligjet nga neni 81.1 i Kushtetutës **nuk janë ligje organike**, sepse si të tilla nuk autorizohen nga Kushtetuta, ani pse materia që normohet me to është e natyrës së ligjeve organike. E njëjta vlen edhe për Ligjin nr. 03/L-21 për Gjykatën Kushtetuese, Ligjin nr. 03/L-199 për Gjykatat, Ligjin nr. 03/094 për Presidentin, ligjin (eventualisht që mund të miratohet) për qeverinë, për aktet normative, ushtrinë dhe kështu me radhë. Këto nuk janë të tilla, jo vetëm sepse nuk kanë autorizim e definim kushtetues, por edhe për shkak se janë miratuar me një shumicë të thjeshtë, pra në një procedurë të rregullt për miratimin e ligjeve. Këto ligje mund eventualisht të quhen "ligje sistemike", shprehje që i takon sistemit komunist me të cilin janë nënkuptuar ato ligje që në mënyrë sistemike (gjithëpërfshirëse) kane rregulluar një materie, e cila zakonisht ka qenë kushtetuese vetëm tërthorazi.

---

vendimit të sipërcekur të **GJKKro**.

224 Historikisht shikuar, **ligjet organike** kanë lindur për të vënë në jetë normat kushtetuese mbi organizimin e organeve të pushtetit, prandaj edhe quhen ligje organike sepse kanë normuar jetën dhe punën e organeve kryesore të pushtetit duke marrë parasysh kushtetutën si akt suprem. Në këtë kuptim, vetë kushtetuta, në esencë, paraqet një lloj të ligjit organik sepse ka të bëjë me rregullimin e shtetit si një strukturë organike, me subjektivitet të ndarë nga ata që punojnë në të dhe për të, siç e ka konstatuar dijetari gjerman **Rudolf fon Jering** (Rudolph von Jhering: 1818-1892). Më vonë, në këtë kategori kanë hyrë edhe liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve.

225 Në **Francë**, të kësaj natyre janë, ta zëmë, ligji mbi zgjedhjen e presidentit të Republikës, ligji mbi Senatin dhe ligji për Kuvendin nacional. Para miratimit të tyre, këto ligje i nënshtrohen kontrollit preventiv të kushtetutshmërisë nga **Këshilli Kushtetues** (KKFr). Louis Favoreu et. al, *Droit constitutionnel* (Dalloz: Paris, 2017), fq. 142-143, 352.

Dallimi në mes të ligjeve të zakonshme dhe ligjeve organike, ndërkaq, konsiston në natyrën e tyre dhe bazohet ekskluzivisht në llojin e materies dhe procedurës kushtetuese për prodhimin e tyre dhe, mbi të gjitha, në kriterin që nxjerrja e tyre duhet të ketë një autorizim (përcaktim) shprehimor kushtetues. Pa qenë të përcaktuara me kushtetutë dhe pa ndjekur një procedurë më të vështirësuar për miratimin e tyre, nuk mund të cilësohen ligje organike.[226] U mor vesh, ato **de facto** mund të jenë të tilla, siç ishte rasti mësipërm në Kroaci kur GJKKro kishte konstatuar një gjë të tillë për ligje të caktuara që kishin qenë të emërtuara si ligje kushtetuese.

Ligjet (e zakonshme) që përmbajnë materie kushtetuese janë burim i të drejtës kushtetuese. Të kësaj natyre janë, ta zëmë, ligjet mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, mbi zgjedhjet, organet e ndarjes horizontale dhe vertikale të pushtetit. Bëhet fjalë për burimin plotësues dhe subdidiar të së drejtës kushtetuese, krahasuar me kushtetutën si burim kryesor dhe primar. Domosdoshmëria e ligjit si burim i të drejtës kushtetuese rrjedhin nga fakti se kushtetuta paraqet akt që nuk normon në plotësi dhe në mënyrë të detajuar tërë materien kushtetuese, kurse dispozitat e saj janë shumë abstrakte dhe të përgjithësuara. Me ligj përpunohen dhe konkretizohen normat kushtetuese.

Miratimi i ligjeve ndjek një procedurë më të thjeshtë se miratimi i normave kushtetuese. Për këtë arsye, fuqia juridike e ligjit është më e vogël se fuqia juridike e kushtetutës. Kjo fuqi juridike nënkupton gjithashtu se ligji mund të ndryshohet vetëm me ligj të ri, duke hequr nga rendi juridik qoftë pjesërisht (**derogimi**) apo në tërësi (**abrogimi**) dispozitat e ligjit të vjetër. Procedura e thjeshtëzuar e ligjvënies tregon se me ligje mund të reagohet më shpejt dhe më lehtë ndaj ndryshimeve shoqërore. Në mënyrë të njëjtë, kur realiteti shoqëror shpërfaq se ligji ose normat e caktuara të tij nuk i përshtaten realitetit në fjalë, ato shumë shpejt dhe lehtë mund të ndryshohen. Për këtë arsye, ligji është një burim i dëshiruar i të drejtës kushtetuese.

Ligji çdo ditë e më shumë po bëhet burim i të drejtës kushtetuese. Gjatë vitit miratohen me qindra ligje, por, megjithatë, jo të gjitha janë burime të së drejtës kushtetuese. Për këtë arsye, ligji jo vetëm që duhet të jetë në pajtim me kushtetutën, por të jetë përplotësues edhe me ligjet tjera, duke bërë kësisoj sistemin juridik harmonik. Sistemi juridik, i përkryer dhe i plotë, paraqet një utopi, të cilën, megjithatë, duhet ndjekur dhe synuar. Kjo bëhet me miratim të një numri më të vogël të ndryshimeve ligjore, plotësimin e zbrazëtirave juridike, eliminimin e dispozitave kundërthënëse, qartësinë e rregullave ligjore.

Akte të posaçme me fuqi ligjore janë ato që i miraton pushteti ekzekutiv, jo parlamenti. Ky i fundit i delegon pushtetit ekzekutiv kompetencën miratimin e akteve të tilla që rregullojnë materien ligjore (ta zëmë, **Franca**, **Kuba** dhe **Libia**), duke rezervuar për vete të drejtën për kontrollim, shfuqizim apo anulim. Në këtë kuptim, në disa vende shefi i shtetit ka të drejt për të miratuar dekretligje, si lloj i akteve me fuqi ligjore. Përkundër këtyre mundësive dhe përvojave kushtetuese të bazuara në to, ekziston sfera kushtetuese e njohur si "rezervë ligjore". Ky institut përcaktohet me kushtetutat e disa vendeve, ku sigurohet që një materie e caktuar mund të normohet vetëm me ligj, assesi me akte të tjera që kanë fuqi ligjore dhe nuk janë autorësi e parlamentit. Të tilla janë, ta zëmë, kompetencat e vetëqeverisjes lokale apo fitimi dhe humbja e shtetësisë.

Aktet nënligjore që përmbajnë materie kushtetuese janë burime plotësuese të së drejtës kushtetuese. Fuqia e tyre juridike është më e ulët se e ligjit. Për të qenë burim i të drejtës kushtetuese, akti nënligjor duhet të plotësojë edhe disa kushte. Në rend të parë duhet që kushtetuta të parashikojë që një pjesë e caktuar e materies kushtetuese normohet me akt nënligjor (ta zëmë, me statut të komunës). Pastaj duhet që kushtetuta të përcaktojë se cilat janë ato çështje kushtetuese që mund të normohen me akt nënligjor.

[226] Louis Favoreu et. al, *Droit constitutionnel*, fq. 160-161); Philippe Ardant & Bertrand Mathieu, *Droit constitutionnel et institutions politiques* (LGDJ: Paris, 2016, fq. 72-73); Olivier Duhamel & Guillaume Tusseau, *Droit constitutionnel et institutions politique* (Seuil: Paris, 2013, fq. 293-294, 302-303 etj.); Oliver Gohin, *Droit constitutionnel* (Lexis Nexis: Paris, 2013, fq. 638-639, 980-981).

Dhe, së fundi, kushtetuta duhet në mënyrë të qartë të përcaktojë procedurën e kontrollimit të akteve nënligjore që janë burim i të drejtës kushtetuese.

Në vijim veçojmë disa prej akteve nënligjore që janë burim i të drejtës kushtetuese. **Rregullorja** (**rregullativa)** e pushtetit ekzekutiv (qeverisë) është akt i përgjithshëm me të cilin pushtetit në fjalë ekzekuton një ligj dhe, përmes ligjit, edhe kushtetuta. Për shkak të fuqisë së ulët juridike, me rregullore nuk mund të ndryshohet ligji, më të cilin duhet të jenë në pajtueshmëri. Një lloj i posaçëm i rregullativës janë aktet që miratohen në situatat e gjendjes së jashtëzakonshme. Ato zakonisht miratohen me dekret dhe urdhëresat kanë fuqinë e ligjit dhe veprim të kufizuar në kohë. Në rastet kur me to ndryshohet materia kushtetuese, siç është, ta zëmë, regjimi i lirive dhe të drejtave të njeriut, praktikisht kanë fuqinë e aktit kushtetues. Me këto akte, megjithatë, nuk mund të ndryshohet kushtetuta, i nënshtrohen kontrollit të detyrueshëm të parlamentit, i cili duhet të jap pëlqimin për to dhe konfirmimin e tyre, në momentin e parë që ai mund të mblidhet. Pa këtë pëlqim dhe konfirmim nga ana e parlamentit, rregullativa e nxjerr gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme nuk mund të mbetet në sistemin juridik.

Rregulloret e organeve të pushtetit: parlamentit, qeverisë, gjykatës kushtetuese, organit për organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve (komision apo emërtim tjetër) dhe organeve të tjera shtetërore janë burim plotësues i të drejtës kushtetuese. Me këto akte nënligjore rregullohet puna e organeve të pushtetit, ashtu që plotësohen dispozitat kushtetuese dhe ligjore lidhur me këto organe. Këto akte duhet të jenë në pajtim me kushtetutën dhe ligjin, por nuk janë në marrëdhënie reciproke ndërmjet vete sepse kanë të bëjnë me punën e vetëm një organi të pushtetit, që dallon prej punës së organit tjetër, konform parimit dhe rregullativës mbi ndarjen dhe balancimin e pushtetit.

Nga rregullorja varet efikasiteti i organit shtetëror, në veçanti kur bëhet fjalë për parlamentin, por edhe për organet tjera. Për këtë arsye shpesh thuhet se më vështirë është të përpilohet një rregullore se një kushtetutë. Në fakt, rregullorja më e rëndësishme cilësohet rregullorja e parlamentit, me të cilën rregullohet në mënyrë të detajuar procedura e ligjbërjes dhe procedurat tjera parlamentare. Ky akt miratohet me një shumicë të njëjtë ose edhe më të madhe, të kualifikuar, se ligji. Kjo bënë që të shtrohet dilema nëse ky akt duhet të futet në grupin e akteve nënligjore apo në akte ligjore. Mënyra e miratimit të rregullores së parlamentit, megjithatë, nuk përfaqëson procedurë ligjore dhe me të nuk mund të ndryshohen apo shfuqizohen ligjet.

Statutet e autonomive territoriale dhe njësive të vetëqeverisjes lokale janë burim plotësues i të drejtës kushtetuese, kryesisht me fuqi juridike të akteve nënligjore. Këto akte juridike konsiderohet si "kushtetuta të vogla", me të cilat rregullohet pozita e organeve të organizimit regjional dhe lokal të pushtetit.

Organet që organizojnë dhe mbajnë zgjedhjet (komisionet zgjedhore) nxjerrin akte të përgjithshme juridike me të cilat rregullohet procedura e zgjedhjeve dhe veprimet zgjedhore – udhëzimet, rregullat dhe rregulloret. Këto janë akte juridike nënligjore dhe burim plotësues i të drejtës kushtetuese. Edhe pse zakonisht kanë natyrën e rregullave teknike, siç janë: rregullat mbi pamjen e vendvotimit, mbi pranimin dhe dorëzimin e materialit zgjedhor, megjithatë bëhet fjalë për burime të së drejtës kushtetuese sepse rregullat mbi zgjedhjen janë pjesë e materies kushtetuese.

Në të drejtën kontinentale (evropiane), vendimet e gjykatave nuk janë burim i së drejtës sepse obligojnë vetëm palët, veprojnë **inter partes**. Ndryshe paraqitet gjendja në shtetet e sistemit anglo-sakson, në të cilat vendimi gjyqësor shërben si precedent, themel dhe detyrim për vendimet e mëpastajme gjyqësore që kanë të bëjnë me gjendje të ngjashme faktike, përkatësisht shërbejnë si bazë për krijimin e të drejtës së mëvonshme (**stare decisis**). Sipas këtij mekanizmi, kur vendimi gjyqësor i referohet materies kushtetues, atëherë vendimi i mëhershëm gjyqësor shërben si burim i të drejtës kushtetuese. Vendimet e gjykatave kushtetuese janë të këtij lloji sepse kanë të bëjnë me materie kushtetuese. Ky lloj i gjykatave janë organe shtetërore të specializuara që mbrojnë kushtetutën, përkatësisht kushtetutshmërinë (në disa vende edhe ligjshmërinë), vendimet e të cilave veprojnë, sipas rregullit, ndaj të gjithëve (**erga omnes**).

Vendimet e gjykatave kushtetuese që vlerësojnë kushtetutshmërinë e një akti, krijojnë rregulla të reja të sjelljes. Kjo sepse gjykatat kushtetuese, në parim, janë **ligjvënës negativ**, siç e ka cilësuar **Hans Kelsen**. Ato vetëm eliminojnë nga rendi juridik dispozitat jokushtetuese të ligjit apo aktit tjetër juridik, duke pushuar (ndërprerë) vlefshmërinë e tyre të mëtejshme. Jokushtetutshmëria mund të përfshijë tërë ligjin apo aktin tjetër juridik që është objekt i vlerësimit kushtetues, jo vetëm një pjesë të dispozitave.[227] Në secilin prej rasteve si më sipër, bëhet fjalë për rregull të re të sjelljes, përkatësisht gjendje e re juridike në sistemin juridik.

Vendimi i gjykatës kushtetuese që interpreton dispozitën kushtetuese, paraqet burim të së drejtës, për shkak se me vendime të tilla gjykata kushtetuese tregon se cili është kuptimi i normës kushtetuese dhe në çfarë mënyre kushtetutëbërësi ka dëshiruar të rregulloj një çështje konkrete që përbën substratin faktit të vendimit interpretues të gjykatës kushtetuese. Ky lloj i interpretimit vlen për të gjitha rastet tjera të zbatimit të normës në të ardhmen, përveç rasteve kur vetë gjykata kushtetuese me vendim të ri shmanget nga precedenti i saj i mëparshëm apo kur kushtetutëbërësi me një normë të re kushtetuese amendamenton dispozitën e interpretuar nga gjykata kushtetuese. Kjo nënkupton se vendimi nuk është vetëpërveti burim autonom i së drejtës, por ekskluzivisht dhe së bashku me dispozitën kushtetuese që e interpreton: në të ardhmen, dispozita kushtetuese që është interpretuar me vendim të gjykatës kushtetuese, gjatë zbatimit nuk mund të interpretohet ndryshe nga se ka thënë gjykatat kushtetuese. Kjo bënë që vendimet e gjykatave kushtetuese të jenë burime shumë specifike dhe të kushtëzuara të së drejtës kushtetuese, që nuk kanë jetë autonome jashtë dispozitave kushtetuese që interpretojnë dhe të cilave iu referohen.

Vendimi i gjykatës kushtetuese mbi kushtetutshmërinë e një norme juridike apo dispozite ka të bëjë me një kontest (mosmarrëveshjesh) kushtetuese konkrete apo abstrakte. Kontesti është konkret kur kryhet vlerësimi i kushtetutshmërisë së një dispozite që duhet të zbatohet në një procedurë që është në vijim e sipër. Mbi këtë mund të vendos vetë gjykata pranë së cilës zhvillohet procedura e tillë, gjykata më e lartë apo gjykata kushtetuese (kur vjen deri te ndërprerja e procedurës) dhe ky vendim vlen vetëm për rastin e tillë konkret. Kontesti i parë i këtij lloji, që shënon krijimin e vlerësimit gjyqësor të kushtetutshmërisë, ka qenë rasti **Marbury v. Madison** (1803), i vendosur nga **Gjykata Supreme Amerikane** (GJSAm). Kur subjektet e caktuara janë të autorizuara për të nisur procedurën e vlerësimit të kushtetutshmërisë së një norme juridike apo dispozitave si tërësi, pa marrë parasysh nëse është duke vazhduar një procedurë gjyqësore për një çështje konkrete, atëherë bëhet fjalë për vlerësimin abstrakt të kushtetutshmërisë apo për kontestin kushtetues abstrakt. Vendimi i dhënë në një situatë të tillë i obligon të gjithë dhe ka efekte përtej palëve në procedurë.

Fare në fund, disa fjalë janë me vend këtu sa i përket burimeve të së drejtës kushtetuese që nuk kanë origjinë nacionale, përkatësisht që kanë origjinë ndërkombëtare dhe që rregullojnë materien kushtetuese. Kushtetutat bashkëkohore çdo ditë e më shumë i kushtojnë një rëndësi të posaçme rregullimit të marrëdhënies në mes të drejtës vendore dhe të drejtës së huaj (asaj ndërkombëtare dhe të drejtës që prodhohet në shtetet e

[227] Forma e **ligjvënies negative** paraqet një standard mjaft të përhapur në gjyqësinë kushtetuese evropiane dhe më gjerë. Ajo është shenjë dalluese klasike e kësaj gjyqësie krahasuar me format tjera të veprimtarive shtetërore. Në këtë formë veprimi, gjykatat kushtetuese kufizohen në rolin e tyre klasik të **ligjvënësit negativ**, duke mos ushtruar kontroll kushtetues më shumë se që është nevoja dhe, për pasojë, duke kufizuar caqet e anulimit të prodhimit të ligjvënësit vetëm për aq sa një gjë e tillë paraqitet si e domosdoshme. Me këtë koncept identifikohet vetë lindja e gjyqësisë kushtetuese në **Evropë**, që nga dita kur kjo shprehje u përdor nga arkitekti ideor i gjyqësisë kushtetuese evropiane, **Hans Kelsen**. Te kjo formë synohet të tregohet se, kur gjykatat anulojnë ligje, ato nuk bëjnë asgjë tjetër pos një veprim të ligjvënies specifike, e cila ka natyrë negative, në sensin që ligjvënësit i bëhet me dije dhe i vihet në dukje se si nuk duhet të veprojë në kundërshtim me parametrat dhe standardet e përcaktuara me kushtetutë. Parlamentet, sipas **Hans Kelsen**, janë "ligjvënës pozitiv", sepse ata bëjnë ligjet në mënyrë të lirë, duke u kufizuar vetëm me normat e kushtetutës (ta zëmë, rregullat e procedurës). Kjo nuk vlen për gjyqtarët kushtetuese, të cilët janë "ligjvënës negativ", sepse kufizohen në anulimin e ligjit kur ai bie ndesh me kushtetutën. Këtë koncept, **Hans Kelsen** e ka shprehur teorikisht për herë të parë në një shkrim të botuar në gjuën frënge në vitin 1928. Cf. më shumë në **Hans Kelsen**, "La garantie juridictionnelle de la constitution (La justice constitutionnelle)". *Revue du droit public et de la science politique en France et a l'etranger* XXXV (Librarie General de Droit et de Jurisprudence, Paris 1928) fq. 185-257; Cf. edhe Hans Kelsen, "Judicial Review of Legislation: A Comparative Study of the Austrian and the American Constitution". *The Journal of Politics,* Vol. 4 No. 2 (May, 1942) fq. 183-200.

huaja). Në vijim të këtij normimi, dallohen tri burime të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare: **rregullat përgjithësisht të pranuara të së drejtës ndërkombëtare**, **marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare** dhe **e drejta e organizatave të ndryshme ndërkombëtare**. Këto janë burime ndërkombëtare të së drejtës kushtetuese dhe dallohen nga burimet e huaja, që përfshijnë edhe burimet eventuale që kanë origjinë në një shtet të huaj. Në fakt, në rastin e fundit, sa i përket të drejtës së huaj, më shumë bëhet fjalë për burime të së drejtës kushtetuese që rezultojnë si pasojë e ndikimit të fuqishëm të dizajnit të huaj kushtetues në modelimin e sistemit kushtetues nacional, përmes migrimit të ideve dhe projekteve kushtetuese nga një vend në tjetrin. Sot mund të vërehet se ka një ngjashmëri të madhe në mes të dizajnit kushtetues të vendeve ish-komuniste të **Evropës**, përfshirë këtu vendet fqinje me **Kosovën**, sikundër ka ngjashmëri të madhe në mes të kushtetutave të vendeve ish-komuniste që u krijuan pas **Luftës së Dytë Botërore**.
Krahas këtyre, burimet me origjinë ndërkombëtare kur rregullojnë liritë dhe të drejtat e njeriut kanë zbatim të drejtpërdrejtë në rendin e brendshëm juridik, u mor vesh kur ato janë të ratifikuara nga shtetet. Ka raste, siç është **Kosova** dhe **Bosnje-Hercegovina**, kur në burime të së drejtës ndërkombëtare hyjnë edhe precedentët e **Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut** (GJEDNJ/Gjykata e Strasburgut), të cilat shërbejnë si bazë juridike për vendimmarrje në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut nga ana e gjyqësorëve nacionalë dhe autoriteteve të tjera publike. E njëjta vlen edhe për marrëveshjet dhe instrumentet kryesore ndërkombëtare dhe evropiane në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut. Në rastet kur marrëveshjet dhe instrumentet tjera ndërkombëtare mbi liritë dhe të drejtat e njeriut bëhen pjesë e rendit të brendshëm me ratifikim, atëherë zbatimi i tyre i drejtpërdrejtë nuk dallon nga zbatimi i tyre në vendet që i kanë shndërruar në norma kushtetuese (Kosova dhe Bosnje-Hercegovina). U mor vesh, ky zbatim i drejtpërdrejtë ndodh vetëm me kusht që marrëveshjet dhe instrumentet në fjalë përmbajnë norma të vetëekzekutueshme. Nëse ky nuk është rasti, atëherë nevojitet nxjerrja e legjislacionit implementues për operacionalizimin e normave që nuk kanë natyrë të vetëekzekutuehsme që gjenden në marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare.

Normat përgjithësisht të pranuara të së drejtës ndërkombëtare nuk janë dispozita krejtësisht të shkruara dhe kodifikuara në një dokument ndërkombëtar, por paraqesin një përzierje të rregullave të shkruara dhe të pashkruara, gjerësisht të përkrahura, të arritura civilizuese në lëmin juridike, siç janë rregullat mbi vetëvendosjen e popujve, e drejta për paqe, e drejta për integritet territorial, ndalimi i gjenocidit, piraterisë, skllavërisë, aparteidit etj. Disa nga këto rregulla kanë natyrë **jus cogens**, disa nuk kanë natyrë të tillë. Janë burime të së drejtës kushtetuese për aq sa rregullojnë materie kushtetuese. Në këtë aspekt nuk dallojnë prej burimeve të tjera të së drejtës kushtetuese që nuk janë norma kushtetuese të kushtetutës së shkruar, që kodifikon në mënyrë gjithëpërfshirëse marrëdhëniet kushtetuese.

E drejta e organizatave ndërkombëtare mjaft shpesh rregullohet me kushtetutë të vendit, me të cilën përcaktohet roli dhe pozita e kësaj të drejte, e cila prodhohet nga strukturat institucionale të organizatave ndërkombëtare që zbatohen në të drejtat nacionale të vendeve anëtare dhe vendeve të tjera. E drejta e Bashkimit Evropian (BE) është shembulli më tipik i kësaj situate. Përveç kësaj, një rol të rëndësishëm e ka edhe e drejta e organizatave të mbrojtjes dhe sigurisë, siç është NATO, OKB, OSBE, etj., që krijojnë standarde të caktuara të sjelljes së bashkësive politike kundrejt individit dhe pozitës së tij në shoqëri. Kjo domosdo përbën një burim të rëndësishëm të së drejtës kushtetuese. Kjo është arsyeja që kushtetutat përcaktojnë standarde për anëtarësim në organizata ndërkombëtare dhe statusin juridik-kushtetues të strukturave të tyre normative në rendin e brendshëm juridik. Përveç kësaj, jurisprudenca e organizatave dhe gjyqeve ndërkombëtare shërben si burim i rëndësishëm i të drejtës kushtetuese sepse shërben si një parametër matës dhe unifikues i rendit të brendshëm juridik në sfera të caktuara, në veçanti në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Sipas fizionomisë së tyre, normat përgjithësisht të pranuara dhe çdo burim tjetër i huaj (ndërkombëtar ose me orgjinë nga shtetet tjera) bëjnë pjesë në kategorinë e burimeve materiale të së drejtës kushtetuese.

5.3.1. Burimet e të drejtës kushtetuese në Kosovë

As në Kushtetutën e Kosovës e as në kushtetutat e vendeve fqinje, me përjashtim të **Shqipërisë** dhe **Serbisë** (kushtetutat e të cilave kanë nga një kapitull të posaçëm që bënë fjalë për llojet dhe hierarkinë e burimeve të së drejtës), nuk ekzistojnë dispozita të grumbulluara në një vend që përcaktojnë burimet e së drejtës dhe hierarkinë e tyre në një mënyrë të posaçme.

U mor vesh, përveç për kushtetutën dhe ligjin kushtetues, që çdo herë përfaqësojnë burime themelore të së drejtës kushtetuese, për burimet tjera vlen rregulli i përgjithshëm, përkatësisht se ato janë burime të së drejtës kushtetuese për aq sa për objekt rregullimi kanë marrëdhëniet juridiko-kushtetuese.

Si në shumicën e vendeve që kanë një kushtetutë të kodifikuar, **Kushtetutës së Kosovës** i njihet supremacia (epërsia), pa specifikuar më pas në asnjë vend se cilat janë aktet tjera juridike që shërbejnë si burim i së drejtës në përgjithësi, i të drejtës kushtetuese në veçanti. Kësisoj është edhe në shumicën e vendeve: ato gjenden të shkapërderdhura nëpër tekstin kushtetues, kryesisht në pjesën që ka të bëjë me juridiksionin e organeve kushtetuese, në kohë paqeje dhe në kohë të gjendjes së jashtëzakonshme. Doktrina kushtetuese, ndërkaq, bënë klasifikimin e tyre në burime materiale dhe burime formale, duke vënë në dukje se cila është fuqia e tyre juridike brenda sistemit juridik nacional. Sikundër do të shihet në vijim, klasifikimi i burimeve të së drejtës kushtetuese në vendet tjera përreth **Kosovës** është kryesisht rezultat i përpjekjeve dhe punës së palodhur të shkencës mbi të drejtën kushtetuese.

Kushtetuta e Kosovës është burimi suprem i të drejtës kushtetuese kosovare. Ky stipulim haset në nenin 16, që flet për supremacinë e kushtetutës, duke konstatuar qysh në paragrafin e parë se "[...] Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë". Kjo, megjithatë, nuk ka qenë gjithherë kështu: në historinë kushtetuese të Kosovës, që njihet si periudha e pavarësisë së mbikëqyrur (shkurt 2008-shtator 2012), Kushtetuta nuk ka qenë akti suprem në tërë territorin e Kosovës: në këtë periudhë ka vlejtur supremacia (epërsia) e Planit Ahtisari, si një prej zotimeve ndërkombëtare që Kosova ka marrë me rastin e shpalljes së pavarësisë së saj. Kjo epërsi ka qenë e konstatuar në mënyrë shprehimore në dispozitat kalimtare të nenit 145 që normonin statusin kushtetues të Planit Ahtisari dhe organeve të krijuara prej tij. Siç shihet, kjo supremaci ka qenë e përkohshme, prandaj edhe me Kushtetutë është sanksionuar në dispozitat kalimtare, dhe është përcaktuar sipas vetë autorizimit të kushtetututëbërësit kosovar me rastin e ushtrimit të pushtetit konstituiv derivativ gjatë miratimit të Kushtetutës.

Kushtetuta e Kosovës është miratuar më 9 prill 2008 nga Kuvendi i Kosovës, që ka vepruar si ushtrues i pushtetit konstituiv derivativ në vijim të zbatimit të **grundnormës** së vet- **Deklaratës së Pavarësisë** (17 shkurt 2008). Ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008, tre muaj pas miratimit. Aktualisht ka162 nene dhe është amendamentuar njëzetë e gjashtë herë. Sa i përket aspektit funksional, Kushtetua qartë përcakton **modelin konsociacional të demokracisë**, i cili model përshkon (dhe reflektohet në) **Deklaratën e Pavarësisë**, në preambulë dhe çdo normë të saj: preambula e cilëson Kosovën si një shtet të të gjithë qytetarëve të barabartë, kurse dispozitat kushtetuese operative fuqizojnë komunitetet duke prodhuar këtë rezultat:

- e para, koalicionet e mëdha në nivel qendror;
- e dyta, autonominë kulturore segmentare në nivel qendror dhe një vetëqeverisje të thellë lokale;
- e treta, proporcionalitetin në përfaqësim pa marrë parasysh fuqinë zgjedhore; dhe
- e katërta, të drejtën e vetos së pakicave në çështjet që prekin interesat e tyre vitale.

Ligji si burim i të drejtës kushtetuese në Kosovë ekziston vetëm në formën e ligjit të zakonshëm, përfshirë ligjet që miratohen me një shumicë absolute (konform nenit 81 të Kushtetutës), në ndërkohë që kategoria e **ligjeve organike** dhe **ligjeve kushtetuese** nuk njihen në sistemin kushtetues kosovar. Ligjet

e Kosovës janë burim i të drejtës kushtetuese për aq sa ato rregullojnë materie kushtetuese, siç janë ligjet që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat e njeriut, zgjedhjet dhe procesin zgjedhor, organet e shtetit dhe kështu me radhë. Ani se në Kushtetutë nuk thuhet, në rendin juridik kushtetues kosovar vlen parimi i prezumimit të kushtetutshmërisë së ligjeve të nxjerra nga parlamenti, si një prodhim i pashmangshëm i parimit të sigurisë juridike dhe sundimit e ligjit, si dy vlera kushtetuese fundamentale. Ky prezumim vazhdon deri në momentin kur jokushtetutshmëria e tij konstatohet nga **Gjykata Kushtetues**, apo ndodh shfuqizimi i tij apo i dispozitave të caktuara nga ligjbërësi kosovar.

Kushtetuta e Kosovës nuk përdor shprehjen **akte nënligjore**. Në fakt, ajo nuk përdor as shprehjen **akte juridike**. Për këtë arsye në klasifikimin e burimeve të së drejtës kushtetuese ne nisemi prej klasifikimit standard të ndjekur nga shkenca juridike-kushtetuese. Pas kushtetutës, e cila, siç u tha, gëzon epërsi, dhe ligjeve si burime të së drejtës kushtetuese, një kategori e rëndësishme e këtyre burimeve janë aktet nënligjore. Në këtë mes, aktet juridike që nxjerr **ekzekutivi** zënë një vend të posaçëm: ato mund të klasifikohen doktrinarisht në **dy grupe**, nisur nga fakti se Kushtetuta është e paqartë sa i përket llojeve të tyre dhe përdor terminologji të ndryshme dhe konfuze.[228] Pikërisht për këtë arsye, ndarja e akteve juridike nënligjore të ekzekutivit kosovar në dy grupe, duke e arsyeshme. Në grupin e parë hyjnë aktet juridike që nxjerr **Qeveria e Kosovës** për zbatim të ligjeve dhe, zakonisht, ato kanë formën e **rregulloreve** dhe **udhëzimeve**. Në të dytin hyjnë aktet që nxjerr Qeveria në vijim të ekzekutimit të kompetencave të veta individuale të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj dhe që nuk i referohen zbatimit të ligjeve. Format kryesore të manifestimit të aktivitetit juridik të Qeverisë janë **dekretet**, **vendimet** dhe **urdhëresat.** Ky konstatim mund të nxirret nga leximi i dispozitave kushtetuese, të cilat përmendin vetëm këto tri akte normative me fuqi nënligjore të nxjerra nga ekzekutivi kosovar.

Një grup i akteve të rëndësishme dhe të veçanta që normojnë **materien kushtetuese** dhe që, për rrjedhojë, përfaqësojnë burime të së drejtës kushtetuese, janë aktet që nxjerrin Presidenti i Republikës dhe Qeveria në kohë të gjendjes së jashtëzakonshme. Në bazë të nenit 131, parag. 3,4 dhe 7 të Kushtetutës, si të tilla konsiderohen vendimi mbi shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme dhe dekreti dhe urdhri. Për të qenë të vlefshëm juridikisht, aktet nga paragrafi i 3 dhe 4 duhet të kenë miratimin (pëlqimin) e Kuvendit të Kosovës. Për nxjerrjen e aktit juridik nga paragrafi 7, përkatësisht të urdhëresës nuk kërkohet pëlqimi i Kuvendit, por vetëm konsultimi me të dhe Qeverinë.

Komunat e Kosovës kanë aktet e tyre me fuqi më të lartë juridike, "kushtetutat e vogla", që quhen statute. Për aq sa kanë të bëjnë me **materie kushtetuese**, në veçanti lidhur me vënien në jetë të parimit të ndarjes së pushtetit, liritë dhe të drejtat e njeriut, statutet e komunave janë burim i të drejtës kushtetuese.

Një burim jashtëzakonisht i rëndësishëm i të drejtës kushtetuese në **Kosovë**, materia e lirive dhe të drejtave të njeriut, është precedenti apo jurisprudenca e **GJEDNJ**. Sipas nenit 53 të Kushtetutës, "[...] Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut". Këso stipulimi kushtetues nuk hasim askund gjetiu në rajon e më gjerë, përfshirë **Bosnje-Hercegovinën**, e cila në shtetbërje dhe kushtetutëbërje mban fuqishëm vulën e pushtetit konstituiv të ndërkombëtarizuar. Vendet përreth **Kosovës**, ndërkaq, precedentëve të GJEDNJ dhe vetë **KEDNJ** i njohin një supremaci efektive kundrejt ndaj çdo ligji dhe praktike tjetër vendore që ka të bëjë me liritë dhe të drejtat e njeriut nga lista e KEDNJ-së, por duke ndjekur rrugë tjera, në rend të parë duke u mbështetur në faktin që këto vende kanë ratifikuar KEDNJ-në, ashtu që kanë detyrim ndërkombëtar për të vënë në jetë çdo vendim të GJEDNJ-së që ka të

[228] Në pjesën mbi kompetencat e ekzekutivit kosovar, neni 93 Kushtetuta thotë se Qeveria "[…] merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve"; në pjesën mbi juridiksionin dhe palët e autorizuara, neni 113.2 (1), Kushtetuta thotë se Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë "çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën". Këtu, sikundër shihet, përdor shprehjen dekret, krahas rregulloreve si akte mjaft të shpeshta të karakterit të përgjithshëm.

bëjë me ta. Përmes kësaj rruge, detyrimisht që vendet përreth Kosovës arrijnë të njëjtin rezultat, sepse secili vendim i **Gjykatës në Strasburg** ka statusin e precedentit (doktrina e pakontestueshme **stare decisis**).

Përveç këtij burimi specifik të së drejtës kushtetuese me karakter ndërkombëtar, **Kushtetuta e Kosovës** normon edhe rolin dhe pozitën e të drejtës ndërkombëtare në sistemin juridik – kushtetues të vendit, njëjtë siç bëjnë vendet përreth. Në këtë kuptim **mund të veçohen disa kategori të së drejtës ndërkombëtare** që kanë relevancë kushtetuese, sepse mund të shërbejnë si burim i të drejtës kushtetuese kur objekt i tyre i rregullimit janë marrëdhëniet juridiko-kushtetuese (**materia kushtetuese**). Në rend të parë hyjnë instrumentet ndërkombëtare që, **per constitutionem**, janë bërë pjesë e drejtpërdrejtë e normës kushtetuese të vendit dhe kanë zbatim të drejtpërdrejtë, për aq sa përmbajnë dispozita të vetë ekzekutueshme. Kur nuk përmbajnë dispozita të tilla, atëherë ekziston detyrimi kushtetues për nxjerrjen e legjislacionit implementues për vënien e tyre në jetë.[229] Në grupin e dytë hyjnë traktatet dhe marrëveshjet ndërkombëtare që ratifikohen nga **Kosova** në mënyrë sovrane, siç bëjnë shtetet tjera sovrane dhe të pavarura. Këtu ekzistojnë dy kategori të marrëveshjeve, ato që raftifikohen nga Kuvendi,[230] dhe të tjerat që lidhen drejtpërdrejt nga Presidenti dhe Qeveria, për të cilat vetëm njoftohet Kuvendi.[231] Në dy rastet, ato do të jenë burim i të drejtës kushtetuese vetëm nëse rregullojnë **materie kushtetuese**. Grupi i tretë i burimeve të drejtës ndërkombëtare në të drejtën kushtetuese të Kosovës janë marrëveshjet dhe traktatet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me anëtarësimin e **Kosovës** në organizata ndërkombëtare. Edhe këto mund të jenë burim i të drejtës kushtetuese vetëm nëse për objekt normimi kanë **materien kushtetuese** (zbatimi i drejtpërdrejtë në rendin e brendshëm kushtetues i dispozitave të organizatave ndërkombëtare, të nxjerra në vijim të veprimtarisë së tyre në shtetet anëtare dhe joanëtare, siç është rasti me rregullativën e BE-së dhe NATO-s). Në këtë kategori hyjnë edhe aktet juridike që lidhen me pranimin dhe operimin e forcave të huaja të armatosura në territorin e Kosovës; pastaj, detyrimi i organeve të shtetit për të ndjekur politikat e caktuara ndërkombëtare në sferën e terrorizmit dhe luftimit të krimit të organizuar dhe trafikimit me qenie njerëzore dhe kështu me radhë. Në grupin e katërt hyjnë dispozitat e të drejtës së përgjithshme ndërkombëtare, në rend të parë **zakonet ndërkombëtare**, kur ato kanë për objekt rregullimi një çështje kushtetuese. Në kuadër të këtij grupi, një pozitë të veçantë zënë dispozitat e nenit 33 të Kushtetutës, që flasin për normat **jus cogens**, si normat me fuqinë më të lartë juridike në hierarkinë e normave ndërkombëtare. Kur këto kanë të bëjnë me **materien kushtetuese**, kanë fuqi sipërore më të lartë edhe se vetë **Kushtetuta e Kosovës**, siç dëshmon edhe formimi i **Gjykatës Speciale** me seli në **Hagë** në vitin 2015, që u krijua për të gjykuar krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare të kryera nga ish-pjesëtarët dhe udhëheqësit e **UÇK**.[232] Këto dispozita nga neni 33 i Kushtetutës, si dhe ato që kanë të bëjnë me **Gjykatën Speciale**, në një pjesë bukur të madhe përmbajnë garancione materiale-juridike dhe procedurale-juridike të natyrës juridiko-kushtetuese, që do të thotë se shërbejnë si burim i drejtpërdrejtë i të drejtës kushtetuese në Kosovë.

---

229 Neni 22 i Kushtetutës liston një sërë marrëveshjesh e instrumentesh ndërkombëtare që janë pjesë e rendit kushtetues të vendit, kanë epërsi ndaj çdo ligji apo akti juridik të institucioneve publike. Bëhet fjalë për marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare si në vijim: (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; dhe (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

230 Sipas nenit 18.1 të Kushtetutës, me votat e dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje: (1) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake; (2) të drejtat dhe liritë themelore; (3) anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare; dhe (4) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës".

231 Neni 18, paragrafët 2 dhe 3.

232 Cf. më shumë për Gjykatën Speciale në: Enver Hasani and Getoar Mjeku, "International(ized) Constitutional Court: Kosovo's Transfer of Judicial Sovereignty". Vienna Journal on International Constitutional Law Vol. 13 No. 4 (2019), fq. 378-402; Enver Hasani & Getoar Mjeku, GJYKATA KUSHTETUESE E NDËRKOMBËTARIZUAR: BARTJA E SOVRANITETIT GJYQËSOR NË RASTIN E KOSOVËS". *E DREJTA / LAW* Nr. 1-4 (2019), fq. 7-36.

5.3.2. Burimet e të drejtës kushtetuese në Shqipëri

Sikundër u tha më sipër, **Shqipëria** dhe **Serbia** janë vendet e vetme në fqinjësi të Kosovës që kanë një kapitull të posaçëm që bënë fjalë për burimet e së drejtës dhe hierarkinë e tyre. Përveç për kushtetutën dhe ligjin kushtetues, që çdo herë janë burime primare të së drejtës kushtetuese, për burimet tjera vlen rregulli i përgjithshëm: ato janë burime të së drejtës kushtetuese për aq sa për objekt rregullimi kanë marrëdhëniet juridiko-kushtetuese.

Pjesa e shtatë e **Kushtetutës së Shqipërisë** titullohet "Aktet normative dhe marrëveshjet ndërkombëtare", që do të thotë se bënë fjalë për dy lloje të burimeve të së drejtës kushtetuese: burimet e brendshme dhe burimet ndërkombëtare, me fokus të veçantë në marrëveshjet ndërkombëtare si burim ndërkombëtar i të drejtës kushtetuese.[233] Parë në këtë kuptim, trajtimi i marrëveshjeve ndërkombëtare në kuadër të burimeve të së drejtës bënë pjesë në qasjen standarde që ndjekin mjaft kushtetuta të reja, në veçanti ato të nxjerra pas **Luftës së Dytë Botërore**. Ky standard ka ardhur në shprehje edhe më shumë pas mbarimit të **Luftës së Ftohtë**: kushtetuat e reja të vendeve ish-komuniste, i dedikojnë një pjesë të mirë të dispozitave kushtetuese raportit në mes të drejtës së brendshme të dhe të drejtës kushtetuese.

Në nenin 116 të **Kushtetutës së Shqipërisë**, aktet normative ndahen në tri kategori. Në kategorinë e parë hyjnë ato akte normative që kanë fuqi në gjithë territorin e Shqipërisë. Ato janë: Kushtetuta, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, ligjet dhe aktet normative të **Këshillit të Ministrave**. Në kategorinë e dytë hyjnë aktet normative të pushtetit vendor, që kanë fuqi brenda territorit të tyre. Në të tretin, së fundi, janë katet normative të ministrive dhe organeve drejtuese të institucioneve të tjera shtetërore që kanë fuqi në tërë territorin e Shqipërisë, por brenda juridiksionit të tyre. Në këtë kategori hyjnë edhe aktet normative të institucioneve dhe agjencive të pavarura, si burime të së drejtës kushtetuese, për aq sa kanë të bëjnë me materien kushtetuese. E njëjta vlen edhe për secilin akt normativ nga neni 116 si më sipër, u mor vesh përveç Kushtetutës e cila çdo herë është burim i të drejtës kushtetuese dhe gëzon epërsi (supremaci) kundrejt çdo akti tjetër juridik.

Në kategorinë e ligjeve, **Kushtetuta shqiptare** bënë dallimin në mes të ligjeve organike dhe ligjeve kushtetuese, me të cilat bëhet rishikimi kushtetues. Kushtetutëbërësi shqiptar, megjithatë, nuk ka përdorur këto shprehje. Kjo shihet nga neni 81.2 (pika nën"a") i Kushtetutës, i cili nuk flet për ligje organike. Nga mënyra e miratimit të tyre si dhe materia që normohet, megjithatë, bëhet e qartë se fjala është për **ligje organike**. Në dispozitën e nenit të sipërcekur thuhet se "ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta, miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit". Konstitucionalistët shqiptar këto ligje i cilësojnë si "ligje të përforcuara", për të bërë dallimin e tyre nga ligjet e zakonshme (normale).[234] E njëjta vlen edhe për kategorinë specifike të ligjeve kushtetuese, që gjithashtu nuk emërtohen kësisoj, me të cilat bëhet rishikimi i Kushtetutës. Sipas nenit 177.4 të Kushtetutës, akti juridik me të cilin rishikohet Kushtetuta, që përmban projektamendamentet e saj, ka fizionominë e projektligjit për rishikim të Kushtetutës dhe, meqë amendamenton atë, ka karakterin e ligjit kushtetues. As këtë kategori Kushtetuta nuk e cilëson si ligj kushtetues, ani se i tillë është. Ai mund të miratohet drejtpërdrejtë në referendum ose nga ana e Kuvendit me dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij.

Aktet nënligjore në **Shqipëri** nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë. Kjo është kategoria parësore e akteve nënligjore, të cilat normohen me ligj sa i përket

[233] **Kushtetuta e Shqipërisë**, aktualisht në fuqi, është miratuar në referendum më datën 22 nëntor 1998 dhe ka pësuar disa herë amendament time. Të fundit janë ato që kanë pasur të bëjnë me procesin e **vetingut shqiptar**. Deri atëherë, si kushtetutë ka vlejtur **Ligjit Nr. 7491, datë 29.4.1991 PËR DISPOZITAT KRYESORE KUSHTETUESE** dhe shtojcat e tij. Kjo do të thotë se ka qenë ligji kushtetues ai që ka udhëhequr jetën kushtetuese shqiptare deri në miratimin e Kushtetutës së vitit 1998, jo kushtetuta e plotë në kuptimin formal, si një tekst që i kodifikon në mënyrë gjithëpërfshirëse maksimalisht materien kushtetuese. Cf. Luan Omari dhe Aurela Anastasi, *E drejta kushtetuese* ("Dajti 2000": Tiranë, 2017) fq. 15-16.

[234] Cf. Luan Omari dhe Aurela Anastasi, *E drejta kushtetuese*, fq. 44-45.

organit, çështjeve që duhen rregulluar dhe parimet në bazë të të cilave nxirret akti në fjalë (neni 118, paragrafët 1 & 2 i Kushtetutës). Ky autorizim ligjor për nxjerrjen e aktit nënligjor nuk mund të bartet, përcaktohet në formë urdhëruese në paragrafin e fundit të nenit 118 të Kushtetutës. Kjo është kategoria themelore e akteve nënligjore që nxjerr ekzekutivi dhe që dallon nga aktet nënligjore që nxirren për organizimin e brendshëm të Këshillit të Ministrave, institucioneve dhe njësive administrative që varen prej ministrive: neni 119.1 i Kushtetutës e bënë të qartë se rregulloret e **Këshillit të Ministrave**, të ministrive e të institucioneve të tjera qendrore, si dhe urdhrat e Kryeministrit, të ministrave e të drejtuesve të institucioneve qendrore kanë karakter të brendshëm dhe janë të detyrueshme vetëm për njësitë administrative që varen prej tyre. Një parim shumë i rëndësishëm kushtetues është ai në paragrafin e dytë të këtij neni, që përcakton se këto akte nxirren në bazë të ligjit dhe nuk mund të shërbejnë si bazë për të marrë vendime në lidhje me individët dhe subjektet e tjera. Në këtë kuptim, ky përfaqëson një shtyllë të rëndësishme për mbështetje gjatë interpretimit të lirive dhe të drejtave kushtetuese, duke pamundësuar vendosjen mbi këto të drejta me akte të natyrës së brendshme administrative. Këto janë vendimet e Këshillit që nuk nxirren në vijim të ekzekutimit të ligjeve apo akteve të tjera të përgjithshme. Për pasojë, nuk mund të shërbejnë si burime të së drejtës kushtetuese sepse kanë karakter krejtësisht të brendshëm dhe prodhojnë efekt brenda institucionit që i ka prodhuar.

Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë bënë pjesë në burimet e të drejtës kushtetuese, për aq sa normon marrëdhëniet kushtetuese pozitive shqiptare. E njëjta vlen edhe për rregullativën e brendshme të institucioneve të tjera qendrore të Shqipërisë, për aq sa ato normojnë marrëdhënie të natyrës kushtetuese.

Sikundër u tha, **burimet e të drejtës ndërkombëtare** kanë një vend të posaçëm. Në nenin 5 të Kushtetutës flitet për detyrimin kushtetues të Shtetit shqiptar për zbatim të së drejtës ndërkombëtare të detyrueshme për të. Në këtë kategori hyjnë, në rend të parë, marrëveshjet ndërkombëtare, për aq sa ato kanë të bëjnë me materien kushtetuese, në veçanti për liritë dhe të drejtat e njeriut. Pas kësaj vijnë normat e të **drejtës së përgjithshme ndërkombëtare**, **zakonet ndërkombëtare** në veçanti, por edhe **parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare**. Marrëveshjet kanë fuqinë më të lartë se ligji, kur ato janë të ratifikuara konform nenit 121.1 të Kushtetutës. Këtë e specifikon edhe neni i saj 112. 2, që thotë se "një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të".[235]

Fare në fund, sa i përket vendimeve të **Gjykatës Kushtetuese** (GJKShq) si burim i të drejtës kushtetuese, ato duhet të vlerësohen sipas standardit të përgjithshëm që zbatohet në vendet ku ekziston modeli i gjykatave të ndara kushtetuese me juridiksion të qartë dhe të ndarë nga gjyqësori i rregullt (modeli evropian/kelsenian). Në këtë model, gjykatat kushtetuese shërbejnë si **ligjvënës negativ**, pa qëllim që të jenë substitut përfaqësuesit të sovranit në normëbërje. Në këtë kontekst duhen kuptuar përcaktimet kushtetuese në disa vende të **Evropës**, ku të gjitha sforcojnë natyrën **erga omnes** të vendimeve të gjykatave kushtetuese, si vendime përfundimtare, të paapelueshme dhe të detyrueshme për zbatim. Ky stipulim gjendet edhe në Kushtetutën shqiptare, në nenin 132.1. Ky përcaktim, në parim, nuk e ndryshon statusin juridiko-kushtetues të burimeve formale të së drejtës në një sistemin kontinental. Më shumë shërben për të treguar se vendimet e gjykatave kushtetuese janë të vetëekzekutueshme dhe duhet të zbatohen. Kjo është kështu për arsye se, në të shumtën e rasteve, ato nuk gëzojnë mbrojtjen e dhunshme të shtetit, siç ndodh me vendimet e gjyqësorit të rregullt. Për këtë arsye, për vendimet e gjyqësorit të rregullt nuk ka nevojë të thuhet se ato janë të detyrueshme dhe vlejnë për të gjithë, sepse një gjë e tillë dihet: në këto raste është ligji, jo kushtetuta, ai që përcakton fazat në të cilat vendimet e gjyqësorit të rregullt bëhen të përshtatshme për ekzekutim nën kërcënimin e përdorimit të dhunës fizike të shtetit.

[235] Kështu edhe doktrina e të drejtës kushtetuese shqiptare: Cf. Luan Omari dhe Aurela Anastasi, *E drejta kushtetuese*, fq. 14-21.

Në vijim, për arsyet si më sipër dhe për ato që u thanë në pjesën mbi burimet e së drejtës kushtetuese në përgjithësi, vendimet e gjykatave kushtetuese duhet të veçohen dhe dallohen nga burimet tjera të së drejtës kushtetuese, sepse organet që zbatojnë të drejtën, gjyqet dhe organet e institucionet e administratës nuk mund të thirren në vendimin e **GJKShq-së** me rastin e zgjidhjes së rastit konkret. Vendimet e gjykatave kushtetuese që kanë të bëjnë me vlerësimin e kushtetutshmërisë (dhe ligjshmërisë aty ku kanë juridiksion) kanë pasoja për burimet e së drejtës kushtetuese, qoftë kur flitet për marrëveshje ndërkombëtare, ligj, akt nënligjor apo akt tjetër të përgjithshëm: në rastet kur dispozitat e tyre, apo në tërësi aktet e tilla nuk janë në pajtim me kushtetutën, atëherë pushojnë së qeni burime të së drejtës, për aq sa janë jokushtetuese. Në mënyrë të njëjtë, vendimet e gjykatave kushtetuese që jepen në procedura sipas ankesës kushtetuese mund të kenë ndikim në punën e organeve të tjera, sepse ato duhet të ndjekin interpretimin e dhënë nga gjykata kushtetuese lidhur me një liri ose të drejtë kushtetuese që ka qenë objekt vendosje me vendimin e gjykatës kushtetuese. Kjo bënë që të konsiderohet i drejtë mendimi i konstitutcinalistëve shqiptarë, sipas të cilëve vendimet e **GJKSh-së** bëjnë interpretimin e Kushtetutës, por nuk kanë vlerë të barabartë me të. E thënë ndryshe, vendimet e **GJKShq-së**, njëjtë si në rastin e vendeve të tjera të botës që kanë model evropian/kelsenian të gjyqësisë kushtetuese, kanë ndikim dhe prodhojnë pasoja në burimet e të drejtës kushtetuese, por vetë të tilla nuk janë dhe nuk kanë jetë autonome si burime të së drejtës kushtetuese. E thënë me fjalë të tjera, asnjë vendim i gjykatës kushtetuese nuk mund të lexohet në mënyrë të pavarur nga dispozita që ka qenë objekt kontrolli dhe interpretimi kushtetues, në cilëndo procedurë qoftë (konkrete, abstrakte, mendim interpretativ apo procedurë sipas ankesës kushtetuese, në vartësi të juridiksionit që njihet me kushtetutë).

Një burim shumë i rëndësishëm i të drejtës kushtetuese në **Shqipëri** janë **prodhimet normative të organizatave dhe strukturave të tjera ndërkombëtare**, pjesë e të cilave është ajo. Roli dhe pozita e tyre në sistemin kushtetues shqiptar duhet të gjykohet në bazë të formulave kushtetuese specifike që ka përdorur kushtetutëvënësi për integrimin evro-atlantik të Shqipërisë. Duke analizuar me kujdes statusin kushtetues të akteve ndërkombëtare, krahas qëndrimit të përgjithshëm të përshkruar më sipër, në **KShq** janë futur edhe formulime specifike që lidhen me integrimin në organizata ndërkombëtare. Forma e parë ka të bëjë me epërsinë e normave të kësaj organizate mbi të drejtën e vendit: në nenin 122.3 të Kushtetutës shprehimisht qartësohet se normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga **Republika e Shqipërisë** për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj. Forma e dytë parashikon transferimin e pushtetit te një organizatë ndërkombëtare, që është një standard kushtetues mjaft i përhapur në kushtetutat bashkëkohore, përfshirë **Kosovën**: në nenin 123.1 të **KShq-së** përcaktohet se **Republika e Shqipërisë**, në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare, u delegon organizatave ndërkombëtare kompetenca shtetërore për çështje të caktuara.[236]

5.3.3. Burimet e të drejtës kushtetuese në Maqedoni të Veriut

Burimet e të drejtës kushtetuese në **Republikën e Maqedonisë së Veriut**, në esencë nuk dallojnë nga burimet e të drejtës kushtetuese të Kosovës dhe vendeve përreth. Shumëçka që është thënë deri këtu për Kosovën dhe Shqipërinë vlen, **mutatis mutandis**, edhe për burimet e të drejtës kushtetuese në këtë vend dhe anasjelltas: shumëçka që nuk është thënë për Kosovë dhe Shqipëri do të thuhet tani në diskutimin tonë në vijim për burimet e së drejtës në fqinjin tonë lindor. Përveç tekstit të **Kushtetutës së Maqedonisë së Veriut** (KMVer), e miratuar në vitin 1991, e ndryshuar disa herë deri më tani (1992, 1998, 2001, 2008 dhe 2019), si bazë themelore për shtjellimin tonë kemi marrë librin e autorit më me ndikim të së drejtës kushtetuese në këtë vend, **Svetomir Shkariq**.[237]

[236] Cf. më shumë në Luan Omari dhe Aurela Anastasi, *E drejta kushtetuese*, fq. 56-57.
[237] Svetomir Škarič, *Ustavno pravo*, fq. 89-101.

Ndarjen dihotomike të burimeve në burime formale dhe burime materiale të së drejtës kushtetuese e ndjek edhe autori si më sipër. Në burimet materiale autori fut kategoritë si vijon:

- normat përgjithësisht të pranuara të së drejtës ndërkombëtare;
- faktet juridike;
- praktikën gjyqësore;
- teorinë liberale-demokratike; dhe, së fundi,
- programet e partive politike në pushtet.

Sikundër shihet, disa prej tyre i kemi lënë pa diskutuar më sipër, gjë që do të thotë se, diskutimi në vijim, përplotëson shtjellimet tona mbi burimet e të drejtës kushtetuese në Kosovë dhe vendet përreth.

Në burime formale, ndërkaq, autori radhit burimet për sa vijon:

- Kushtetuta dhe ligjet kushtetuese për zbatim të Kushtetutës;
- ligjet e ndryshme (të zakonshme dhe të tjera);
- dekretet me fuqi ligjore të Qeverisë;
- statutet e komunave;
- vendimet e Gjykatës Kushtetuese (GJKMVer) dhe vendimet e **GJEDNJ**; dhe, në fund,
- aktet specifike juridike.

Si burim specifik formal i të drejtës kushtetuese në këtë vend shërben **Marrëveshja e Ohrit**, me të cilin është ndaluar konflikti i armatosur në mes të forcave policore dhe ushtarake të **Republikës së Maqedonisë së Veriut** dhe shqiptarëve të këtij vendi, që rrokën armët për të fituar të drejtat e barabarta civile, politike, sociale dhe ekonomike me popullsinë sllave (maqedono-veriore). Ky burim në literaturë quhet burim **sui generis** i të drejtës kushtetuese dhe futet në kategorinë e akteve specifike juridike.[238]

Burimet përgjithësisht të pranuara të së drejtës ndërkombëtare janë burim i drejtpërdrejtë i të drejtës kushtetuese për shkak se konsiderohen si një vlerë themelore e rendit kushtetues maqedono-verior. Norma të këtij lloji janë: Karta e OKB-së e vitit 1945, konventat ndërkombëtare që përcaktojnë rregulla për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare, marrëveshjet ndërkombëtare që ndalojnë gjenocidin, krimet kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare, Statuti i Gjykatës së Nyrembergut që ka përcaktuar individualizimin e përgjegjësisë individuale për krimet ndërkombëtare, Statuti i Gjykatës Permanente Penale (Gjykata e Romës, e themeluar në vitin 1998 në Romë), zakonet ndërkombëtare dhe parimet e përgjithshme juridike të pranuara nga popujt e civilizuar. Këto norma, që përmbahen në këto dokumente si më sipër, kanë efekt sipëror (superior) në rendin kushtetues të **Maqedonisë së Veriut** dhe në të shumtën e rasteve kanë natyrë juridike të normave **jus cogens**, që nuk mund të ndryshohen veçse me norma të fuqisë së njëjtë juridike. Këto norma, në fakt, shërbejnë si themel i mbijetesës dhe zhvillimit civilizues të bashkësisë ndërkombëtare.[239]

Faktet juridike si burim i të drejtës materiale vërtetojnë ose mohojnë realizimin e rendit kushtetues në praktikë. Përmes tyre mundësohet konstatimi i shkallës së realizimit në praktikë të rendit juridik, niveli i zbrazëtirave juridike dhe cenimet e dispozitave kushtetuese nga subjektët e së drejtës.

---

238 Svetomir Škarič, *Ustavno pravo*, fq. 89 dhe 99-101. Për tekstin e plotë, cf. në **Framework Agreement (Ohrid Agreement)** 13.08.2001. Në internet: https://peacemaker.un.org/fyrom-ohridagreement2001 (shikuar në shkurt 2022). Për komente të tjera lidhur me këtë akt juridik me karakter kushtetues, cf. në Marija Risteska and Zhidas Daskalovski (eds.), *One Decade after the Ohrid Framework Agreement: Lessons (to be) Learned from the Macedonian Experience* (Friedrich Ebert Stiftung and Center for Research and Policy Making: Skopje 2011).

239 Svetomir Škarič, *Ustavno pravo*, fq. 90.

Praktika gjyqësore si burim material paraqitet në dy forma. Forma e parë është kur krijohet një rregull juridik që nuk bie në kundërshtim me kushtetutën në fuqi. E dyta formë, ndërkaq, është kur shtohet një rregull juridike që bie ndesh me dispozitat e kushtetutës në fuqi. Si shembull i formës së parë, sipas S. Shkariq, është praktika e gjykatave që gjykojnë jo vetëm në bazë të kushtetutës, ligjit dhe marrëveshjeve të ratifikuara, por edhe në bazë të drejtëshmërisë. Për të dytën formë, autori merr si shembull praktikën gjyqësore të viteve 1991-1998, kur paraburgimi prej 90 (nëntdhjetë) ditësh ka mund të vazhdohet për rastet e veprave të rënda penale. Kjo praktikë gjqyësore është tejkaluar me amendamentin III të vitit 1998, që thotë se paraburgimi mund të vazhdohet deri në 180 (njëqind e tetëdhjetë ditë), brenda të cilit afat duhet të ngritet aktakuza.[240]

Teoria liberale-demokratike paraqitet si burim material i të drejtës kushtetuese, bazuar në këto parime: e para, teoria në fjalë shërben si bazë për shkrimin e kushtetutës dhe dispozitave të saj; e dyta, kjo teori shërben si bazë për interpretimin e kushtetutës liberale-demokratike; dhe, së fundi, teoria e tillë paraqet pikën themelore të referimit gjatë vlerësimit të zbatimit praktik të kushtetutës. Këto mendohet për vlerat kushtetuese, që ankorohen në teorinë perëndimore liberale demokratike, siç janë: parimi i ndarjes dhe balancimit të pushtetit, sundimi i kushtetutës dhe i ligjit, respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve dhe kështu me radhë.

Programet e partive politike në pushtet përfaqësojnë burim material të së drejtës kushtetuese sepse anëtarët e tyre janë pjesë e shumicës parlamentare që miratojnë ligjet dhe rregullat tjera. Sipas rregullit, shumica parlamentare që miraton aktet juridike në parlament, këtë e bënë në pajtim me programin e partisë politike që i takon (apo partive politike që iu përkasin) dhe që ka shërbyer si bazë për fitimin e zgjedhjeve të drejtpërdrejta.

Burimet formale të së drejtës kushtetuese në Maqedoninë e Veriut, sikundër u pa më sipër, ndahen në pesë grupe.

I pari dhe kryesori ndër to është **KMVer**, burimi formal themelor i të drejtës kushtetuese në këtë vend, për tri arsye themelore: e para, sepse është akti më i lartë juridik; e dyta, sepse është akti me fuqi më të madhe juridike; dhe, së fundi, sepse është akti që rregullon në mënyrën më gjithëpërfshirëse çështjet më të rëndësishme të materies kushtetuese.[241] Amendamentet kushtetuese (I – XXXVI) janë burim i të drejtës kushtetuese sepse janë pjesë përbërëse e KMVer të vitit 1991.

Ligji kushtetues për zbatimin e KMVer i vitit 1991 është gjithashtu burim formal i të drejtës kushtetuese sepse, e para, me te caktohen afatet për miratimin e ligjeve të reja dhe harmonizimin e atyre ekzistuese me KMVer dhe, e dyta, ky akt rregullon çështje që i takojnë fushës së materies kushtetuese. Përveç kësaj, me këtë ligj kushtetues janë përcaktuar kufijtë e Maqedonisë së Veriut. Për herë të parë, Ligji ka pësuar ndryshim në vitin 1992, kur është nxjerr Ligji kushtetues për plotësimin e Ligjit kushtetues të vitit 1991. Më këto plotësime përfundimisht janë ndërprerë lidhjet në mes të organeve shtetërore të Maqedonisë së Veriut dhe organeve të ish-Jugosllavisë. Pas kësaj, në vitin 2005 është nxjerr Ligji kushtetues për zbatimin e amendamenteve XX-XXX, praktikë që më pastaj nuk është ndjekur, përkundër se ka pasur amendamentime substanciale dhe të rëndësishme kushtetuese.[242] Ligjet që miratohen **me dy të tretat** e numrit të deputetëve të Kuvendit të Maqedonisë së Veriut janë një burim i rëndësishëm i të drejtës kushtetuese, sepse kryesisht prekin materien kushtetuese dhe kanë autorizim shprehimor kushtetues. Çështjet që normohen me këtë kategori të ligjeve janë: ligjet që normojnë simbolet shtetërore (stema, flamuri dhe himni), gjykatat, vetëqeverisjen lokale, procedurën

240 Svetomir Škarič, *Ustavno pravo*, fq. 92.

241 Svetomir Škarič, *Ustavno pravo*, fq. 93, (dy arsyet e para janë përcaktim kushtetues i kushtetutëvënësit maqedono-verior, të dhëna në dispozitat e nenit 51 të **KMVer**, kurse arsyeja e tretë është një afirmim doktrinar deskriptiv lidhur mbi natyrën juridike të kushtetutës së shkruar, si një akt që kodifikon në mënyrë gjithëpërfshirëse materien kushtetuese).

242 Ibid., fq. 94.

penale, organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore, mbrojtjen dhe Ligjet që miratohen me **një shumicë absolute**, gjithashtu janë burim i të drejtës kushtetuese për aq sa normojnë materien kushtetuese. Të kësaj natyre janë ligjet zgjedhore (deri në shkrimin e këtyre rreshtave, shkurt 2022, në Maqedoninë e Veriut janë nxjerrë tri ligje zgjedhore).

Ligjet e zakonshme që kanë cilësinë e burimeve të së drejtës kushtetuese janë ligjet që normojnë: shtetësinë maqedono-veriore, Këshillin Gjyqësor, Prokurorinë publike, partitë politike, lirinë e tubimit, ratifikimin dhe ekzekutimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet, referendumin dhe iniciativat qytetare dhe Qeverinë e Maqedonisë së Veriut.

Edhe konstitucionalisti **S. Shkariq** ankohet në kushtetutëvënësin maqedono-verior, i cili, gjithnjë sipas tij, një numër të ligjeve organike i ka lënë në duart e shumicës së thjeshtë (ligjeve të zakonshme), në ndërkohë që me një shumicë të përforcuar prej dy të tretave i ka lënë ligjet që përndryshe kanë karakterin e ligjeve që duhet të miratohen më një shumicë absolute. Më këtë, sipas këtij autori, bëhet përzierje dhe ngatërrim në mes të ligjeve organike dhe ligjeve të zakonshme, në njërën anë, dhe ligjeve kushtetuese dhe ligjeve që miratohen më një shumicë absolute, në anën tjetër. Edhe ky autor pajtohet se me rëndësi është përmbajtja, jo emërtimi i ligjit, njëjtë siç ka bërë gjyqtari kushtetues kroat në vendimin e sipërcekur, sipas të cilit disa ligje për nga përmbajtja e tyre dhe mënyra e miratimit janë ligje organike, jo ligje kushtetuese siç emërtohen në titullin e tyre.[243]

Diskutimin për **aktet nënligjore** si burime të së drejtës, **S. Shkariq** e nis me urdhëresat (dekretet) me fuqi ligjore të pushtetit ekzekutiv të Maqedonisë së Veriut, jo me rregulloret, urdhëresat dhe vendimet tjera të Qeverisë që mund të nxirren në vijim të zbatimit të ligjeve dhe akteve të tjera të përgjithshme. Këto urdhëresa me fuqi ligjore rregullohen me dispozitën e nenit 126.1 të Kushtetutës dhe kanë të bëjnë në tërësi me gjendjen e jashtëzakonshme, kur ekzekutivi paraqitet si rregullues primar i marrëdhënieve kushtetuese në periudhën sa zgjatë gjendja e tillë. Tërë kjo, megjithatë, nuk do të thotë se ky vend fqinj nuk sanksionon kategorinë e akteve nënligjore që ka të bëjë me rregullativën qeveritare për ekzekutimin të ligjeve dhe akteve të tjera të parlamentit: në nenin 91 të KMVer thuhet se Qeveria jo vetëm që përcakton politikat e zbatimit të ligjeve dhe rregullave të tjera të Kuvendit, por edhe mban përgjegjësi për një gjë të tillë. Se kjo është kështu, bëhet e qartë menjëherë në pikën e pestë të paragrafit të parë të nenit të njëjtë të KMVer, nenit 91, që thotë se Qeveria "miraton urdhëresa dhe rregulla të tjera për zbatimin e ligjeve". Këtu, pra, bëhet fjalë për rregullativë qeveritare që ka cilësinë e akteve nënligjore, që miratohen në vijim të zbatimit të ligjeve dhe akteve të tjera të Kuvendit.

Pas diskutimit për **urdhëresat me fuqi ligjore**, pason shtjellimi i **rregulloreve** të Kuvendit të Maqedonisë së Veriut si burim i të drejtës kushtetuese. Me këtë akt juridik normohet organizimi i brendshëm dhe puna e Kuvendit, siç ndodh edhe në Kosovë dhe në vendet tjera përreth. Të njëjtën fuqi juridike dhe status kushtetues e kanë edhe rregulloret mbi punën e **GJKMVer**.[244]

Statutet e komunave janë burime formale të së drejtës kushtetuese sepse me to në mënyrë origjinale rregullohen marrëdhëniet kushtetues brenda kufijve të juridiksionit kushtetues të vetëqeverisjes lokale. Si të tilla, kanë rëndësi të madhe sepse me to përcaktohet marrëdhënia në mes të lirisë dhe pushtetit, në njërën anë, dhe pushtetit qendror dhe vetëqeverisjes lokale, në anën tjetër. Me statut dimensionohet cilësia dhe arritjet e demokracisë lokale.[245]

Vendimet e **GJKMVer**, sipas **S. Shkariq**, shërbejnë si burime të së drejtës kushtetuese në vartësi të karakterit të tyre: vendimet që shqiptohen në vijim të kontrollit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë

[243] Svetomir Škarič, *Ustavno pravo*, fq. 96, (këtë konstatim, **S. Shkariq** e bazon në një mendim të ish-presidentit amerikan **Barak Obama**).
[244] Ibid., fq. 98.
[245] Ibid., fq. 98.

(vendimet gjatë kontrollit abstrakt të normave) kanë efekt të përgjithshëm për subjekt të së drejtës, për shkak se me to bëhet interpretimi i KMVer. Kushtetutë është ajo çfarë vendosin gjyqtarët kushtetues, konstaton ky autor. [246]

Sa i përket vendimeve të **GJEDNJ-së**, autori konstaton se janë burime të së drejtës kushtetuese sepse me to bëhet harmonizimi i të drejtës maqedono-veriore me të drejtën evropiane.[247] Kjo bëhet sepse ka me mijëra ankesa në **GJEDNJ** kundër këtij vendi, që janë ngritur nga qytetarët e tij, dhe që kanë pasur sukses dhe, për pasojë, kanë arritur të imponojnë një standard për të drejtat e njeriut në organet e pushtetit shtetëror maqeodno-verior. Sikundër mund të vërehet nga **KMVer**, **KEDNJ** nuk ka zbatim të njëjtë si në **Kosovë** ose **Bosnje-Herceogivinë**, ku ajo ka statusin e normës kushtetuese, por si një marrëveshje e ratifikuar, që ka fuqinë më të lartë se çdo ligj, por jo më të lartë se **KMVer** (neni 118). Kjo bën që organet e pushtetit publik të interpretojnë liritë dhe të drejtat nga **KMVer**, duke pritur që më pastaj të ndërmerren hapat adekuat për harmonizim të rendit juridik-kushtetues me atë evropian, si pasojë e humbjeve të proceseve gjyqësore në **Strasburg**. Kjo është krejt e natyrshme: që në fillim, në nenin 8, kur flet për vlerat kushtetuese, kushtetutëvënësi maqedonoverior përmend liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe të qytetarit, të njohura me të drejtën ndërkombëtare dhe të përcaktuara me Kushtetutë. Kjo do të thotë se përcaktimi kushtetuese determinon caqet dhe nivelin e garancionit mbi liritë dhe të drejtat e njeriut në Maqedoninë e Veriut. Për më tepër, këtë pikëpamje e vërteton fakti që në pjesën e **3 të kapitullit të dytë ("Garancitë e lirive dhe të drejtave themelore") të KMVer** flitet për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të përcaktuara me Kushtetutë.

Marrëveshja e Ohrit, ka natyrë **sui generis** të burimit të së drejtës kushtetuese. Ajo është nënshkruar në **Shkup** më 13 gusht 2001, në mes të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut dhe përfaqësuesit e palës shqiptare në këtë vend. Nënshkrimin e saj e kanë vënë katër partitë kryesore politike të Maqedonisë së Veriut (sllavo-maqedone dhe shqiptare), pas kërkesës së ndërmjetësuesve ndërkombëtarë për të marrë zotimin e tyre se ratifikimi dhe implementimi i Marrëveshjes do të kryhet për katër vjet.

Marrëveshja ka krijuar kushtet juridiko-kushtetuese për ndërtimin e Maqedonisë së Veriut si shtet civil, duke përfunduar konfliktin e armatosur në mes të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe forcave të sigurisë së Maqedonisë së Veriut, për shtatë muaj, gjatë vitit 2001. Me të parashihej ndërmarrja e një sërë veprimesh, siç janë: ndërprerja e armiqësive, çarmatosja vullnetare e grupeve të armatosura të shqiptarëve etnik, bartje e pushtetit, dhe reforma e të drejtave politike dhe kulturore të minoriteteve.

Marrëveshja gjithashtu ka paraparë ndryshimin e dispozitave mbi gjuhët zyrtare të Maqedonisë së Veriut, ashtu që tani e tutje çdo gjuhë që flitet nga më shumë se 20% e popullatës do të jetë gjuhë zyrtare, krahas gjuhës sllavo-maqedone. Meqë vetëm gjuha shqipe flitet nga së paku 25% (njëzetepesë përqind) e popullsisë së këtij vendi, efektivisht gjuhë zyrtare me Marrëveshje bëhet vetëm gjuha shqipe. D.m.th., ky kriter është ndërtuar me një gjuhë neutrale, por në praktikë bëhet fjalë për gjuhën shqipe. Në aspektin kushtetues, kjo përbën një të metë sepse realizimi i barazisë së popullit shqiptar atje i nënshtrohet kriterit biologjik, që mund të ndryshojë në të ardhmen. Prandaj më e drejtë në aspektin kushtetues do të kishte qenë përmendja shprehimore e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare, krahas gjuhës sllavo-maqedone.

Marrëveshja është shembull tipik i përqafimit të **demokracisë konsociacionale**, ku diversiteti etnik, gjuhësor, fetar dhe çdo diversitet tjetër, për të qenë i akomoduar, diversifikohet edhe më shumë në mënyrë artificiale. Kjo më pas është reflektuar në norma kushtetuese e ligjore. Një qasje e tillë shihet që në fillim të Marrëveshjes ku konfirmohet karakteri shumetnik i shoqërisë maqedonoverior, i cili duhet të ruhet dhe të gjejë shprehjen e vet në jetën publike të vendit. Krejt kjo bëhet me qëllim të kri-

[246] Svetomir Škarič, *Ustavno pravo*, fq. 99.
[247] Ibid., fq. 99.

jimit të barazisë së të gjitha formave të manifestimit të diversitetit në një shtet. Në këtë rast, identiteti shqiptar, i cili deri atëherë ka qenë i shtypur, i fshehur dhe i injoruar, del në syprinë dhe reflektohet në çështjet e gjuhës, të drejtave politike dhe kulturore, punësim dhe arsimim, polici dhe gjyqësi. Në sferën politike kemi formimin e trupave të ndryshëm në nivel të organeve qendrore dhe krijimin e parimit të dyfishtë për votim lidhur me të drejtat e komuniteteve pakicë (parimi i njohur si **Badinter**). Krahas multietnicitetit, integriteti dhe sovraniteti i Maqedonisë së Veriut ngelet i pacenueshëm. Me Marrëveshje palët zotohen për respektimin e tij. Për më tepër, shprehimisht konstatohet se nuk do të ketë zgjidhje territoriale për çështjet etnike, që nënkupton se diversiteti etnik dhe tjetër duhet të kultivohet, promovohet dhe mbrohet brenda territorit të shtetit sovran të Maqedonisë së Veriut.

Sipas Marrëveshjes, gjuha angleze është e vetmja gjuhë autentike.

Qeveria dhe pushteti maqedonoverior kanë qenë të detyruar që të miratojnë ndryshimet përkatëse kushtetuese e ligjore, me qëllim që shqiptarët, si komunitet pakicë, të realizojnë të drejtat e numëruara në Marrëveshje, në sferat për sa vijon: pushteti lokal, mosdiskriminimi dhe përfaqësimi i drejtë në të gjitha nivelet e pushtetit shtetëror; procedurat e posaçme kuvendore, ku nuk mund të miratohet norma apo politikë tjetër pa përfaqësim të komuniteteve që janë pakicë (siç u tha, konform parimit Badinter); arsimimi, përdorimi i gjuhëve, simbolet kombëtare dhe çështjet të tjera.

Negociator kryesor nga Bashkimi Evropian ka qenë François Léotard, kurse në emër të SHBA-së ka qenë ndërmjetësues diplomati i mirënjohur dhe miku i shqiptarëve, **Xhejms Perdju** (James W. Pardew: 1944-2021). Njëra palë, ajo shqiptare, e ka paraqitur marrëveshjen si fitore, kurse percepcioni i sllavo-maqedonëve është se ajo është një humbje dhe një e keqe e domosdoshme për ta.[248]

5.3.4. Burimet e të drejtës kushtetuese në Mal të Zi

Edhe në rastin malazez, si bazë diskutimi për burimet e të drejtës kushtetuese kemi marrë tekstin e **Kushtetutës së Malit të Zi** (KMZi), në fuqi që nga viti 2007, kur vendi u pavarësua nga **Serbia**,[249] si dhe librin kryesor të doajenit malazez të së drejtës kushtetuese, akademikut **Mijat Shukoviq** (Mijat Šuković: 1930 – 2011).[250] Për dallim nga autorët tjerë pararendës, ky autor nuk flet për burimet e të drejtës kushtetuese pozitive në vendin e tij, por në përgjithësi për burimet e kësaj dege të së drejtës. Ajo që çuditë është se në pjesën mbi burimet e të drejtës kushtetuese, flet për burimet e shkencës mbi të drejtën kushtetuese, në ndërkohë që brendia e diskutimit shpalos faktin se bëhet fjalë për burimet e të drejtës kushtetuese si degë e së drejtës, jo si degë e shkencës juridike (sic!).[251] I vetmi burim i të drejtës kushtetuese pozitive, **KMZI**, diskutohet në pjesën e fundit të librit, duke lënë anash diskutimin për burimet tjera të së drejtës. Me sa duket ky autor e merr si të mirëqenë faktin se, diskutimi për burimet e të drejtës kushtetuese vlen, **mutatis mutandis**, edhe për të drejtën kushtetuese pozitive malazeze. Nga shfletimi i **KMZi**, megjithatë, del se në kuadrin e akteve nënligjore hyjnë edhe rregullativat e ekzekutivit të vendit, të nxjerra në vijim të zbatimit të ligjeve dhe akteve të tjera të përgjithshme të **Kuvendit të Malit të Zi**.[252] Në diskutimin e autorit, megjithatë, listimi i burimeve nuk përfshin aktet nënligjore në mënyrë specifike, duke u fokusuar në kushtetutën, ligjet kushtetuese, ligjet tjera dhe rregulloret e organeve qendrore kryesore (parlamentit, ekzekutivit dhe gjykatës kushtetuese). Nga aktet nënligjore, për trajtim

248 Svetomir Škarič, *Ustavno pravo*, fq. 101.

249 **KMZi** është miratuar dhe ratifikuar në **Kuvendin e Malit të Zi** më datën 19 tetor 2007, kurse zyrtarisht është shpallur më 22 tetor të vitit të njëjtë. Me të është zëvendësuar **KMZi** e vitit 1992, që ka rregulluar marrëdhëniet kushtetetuese para fitimit të pavarësisë dhe sovranitetit të plotë të vendit. Ndryshimet e fundit të saj janë bërë në vitin 2013.

250 Mijat Šuković, *Ustavno pravo* (CID: Podgorica, 2009).

251 Ibid., fq. 14-17.

252 Cf. neni 100 parag. 2 dhe 3 të **KMZi**, që flasin për kompetencat e Qeverisë për ekzekutimin e ligjeve dhe aktetve të tjera të përgjithshme dhe nxjerrjen e rregulloreve, urdhëresave, vendimeve dhe akteve të tjera në vijim të zbatimit të ligjeve dhe akteve të tjera të përgjithshme të **Kuvendit të Malit të Zi**.

janë veçuar vetëm dekretet me fuqi ligjore të nxjerra në kohë të gjendjes së jashtëzakonshme.[253] As statutet e komunave nuk figurojnë në pjesën e shtjellimeve të autorit mbi burimet e së drejtës kushtetuese, ani se në nenin 1115 parag. 2 i **KMZi**, në mënyrë shprehimore përcaktohet se komuna miraton një statut dhe akte të përgjithshme..

Pasi bën klasifikimin e burimeve në të shkruara dhe të pashkruara, primare dhe sekondare, autori kalon te klasifikimi standard i burimeve në burime formale dhe burime materiale të së drejtës kushtetuese. Këto i cilëson ndryshe edhe si burime juridike (burimet formale) dhe burime jojuridike (burimet materiale).[254] Në grupin e burimeve juridike i fut si vijon: kushtetutën, ligjet kushtetuese, ligjet apo pjesët e ligjeve dhe dispozitat të tjera më të cilat normohen segmente të caktuara të materies kushtetuese, për aq sa kanë të bëjnë me marrëdhëniet në fushën që përfshijnë marrëdhëniet themelore shoqërore.[255] Si marrëdhënie themelore shoqërore, sipas autorit, pa dyshim se konsiderohen marrëdhëniet kushtetuese, d.m.th., këtu e ka fjalën për këtë lloj të marrëdhënieve. Në grupin e burimeve, përveç sa u tha më sipër, autori fut edhe kartat, deklaratat, rezolutat me përmbajtje politiko-kushtetuese dhe, për çudi, i vetmi nga autorët në fqinjësi të Kosovës, edhe deklaratat për themelimin apo pavarësinë e shtetit.[256] Më këtë konstatim, ky autor i ofrohet shumë botëkuptimit të saktë sipas së cilit **grundnormë** nuk është norma kushtetuese, me kuptim tekstin formal që kodifikon në mënyrë maksimalisht gjithëpërfshirëse marrëdhëniet kushtetuese, por deklarata mbi përcaktimin e formës dhe përmbajtjes së ekzistencës politike të një populli, e që është deklarata e pavarësisë apo deklarata tjetër e barasvlershme me të (me rastin e nxjerrjes së kushtetutës së re **ab nihilo**, pa krijuar shtet të ri, pra në kuadër të bashkësisë ekzistuese shtetërore, këtë cilësi e ka vendimi politik i përfaqësuesve të pushtetit konstituiv që përcakton parimet e rregullimit të ri politik dhe kushtetues, dhe që mund të ketë emërtime të ndryshme).

Kur flet për burimet materiale të së drejtës kushtetuese, autori përmend **zakonet juridike**, por edhe çdo fakt shkencërisht i vërtetueshëm, pa marrë parasysh formën, që mund të ketë relevancë për rregullimin e marrëdhënieve themelore shoqërore. Zakoneve juridike, megjithatë, ua mohon cilësinë e burimit në vendet e dala nga ish-**Jugosllavia**, Përveç fazës së tranzicionit të tyre nga një sistem në tjetrin, për të kaluar në shtjellimin e tyre në kontekstin e sistemit juridik britanik. Sikur autorët tjerë, përfshirë autorët e këtij libri, **M. Shukoviq** me të drejtë konstaton se praktika gjyqësore në **Britani të Madhe** ka cilësinë e burimit të rëndësishëm juridik-kushtetues. Një ngjashmëri më ketë cilësi, në sistemin kontinental, të cilit i takon edhe **Mali i Zi** dhe krejt vendet tjera të **Ballkanit**, e kanë vendimet e gjykatave kushtetuese. Sipas tij, këto vendime shërbejnë si burime vetëm atëherë kur për objekt kanë vlerësimin e kushtetutshmërisë (dhe ligjshmërisë) së normës juridike (kontrolli abstrakt i normës). Vetëm në këto raste vjen deri te saktësimi, përmes interpretimit nga gjyqtarët kushtetues, i përmbajtjes së përcaktimeve të caktuara kushtetuese, të skicuara nga kushtetutëvënësi konkret. Kjo përputhet në tërësi me stipulimin e **KMZi**, e cila, në nenin 151 parag. 3 dhe 4, konstaton se vendimet e **GJKMZi** janë të detyrueshme për të gjithë dhe, për dallim nga rastet e vendeve të diskutuara deri këtu, janë edhe të ekzekutueshme dhe për këtë kujdeset **Qeveria e Malit të Zi**. Këtu, pra, aparati shtetëror i dhunës fizike shërben si garant për zbatimin e vendimeve të **GJKMZi**, në rastet kur kjo paraqitet si e nevojshme. Sikundër dihet, burimi është burim i së drejtës apo burim juridik, pikërisht për shkak se ka mbrojtjen dhe garancionin e zbatimit përmes dhunës fizike të shtetit, në rastet kur një gjë e tillë paraqitet si nevojë. Ky fakt e dallon burimin juridik apo burimin e së drejtës nga morali, filozofia dhe zakoni popullor, të cilat, për vënien e tyre në jetë, nuk e gëzon mbrojtjen e aparatit të dhunës fizike.[257]

253 Mijat Šuković, *Ustavno pravo*, fq. 15-16.
254 Mijat Šuković, *Ustavno pravo*, fq. 14.
255 Ibid., fq. 14.
256 Mijat Šuković, *Ustavno pravo*, fq. 14.
257 Cf. më shumë për këtë në Enver Hasani, "E drejta kushtetuese dhe të drejtat e njeriut - Parimet dhe institucionet". Në Grup autorësh (eds.), *Hyrje në sistemin ligjor në Kosovë* (Akademia e Drejtësisë: Prishtinë, 2019) fq. 37- 72 në fq. 38.

5.3.5. Burimet e të drejtës kushtetuese në Serbi

Klasifikimi i burimeve të së drejtës kushtetuese në **Serbi**, bazohet kryesisht në ndarjen klasike të burimeve, përkatësisht në ndarjen në burime materiale dhe në burime formale të së drejtës kushtetues. Autori më me ndikim i të drejtës kushtetuese serbe në periudhën pas mbarimit të komunizmit, **Ratko Markoviq** (Ratko Marković*:* 1944-2021),[258] ka përqafuar një qasje më ndryshe nga autorët tjerë në territorin ish-jugosllav sa i përket burimeve të së drejtës në përgjithësi. Me mbështetje në doktrinën italiane mbi kuptimet themelore të burimeve të së drejtës, ky autor bën rigrupimin e tyre në tri grupe me domethënie të ndryshme:[259]

- burimet e prodhimit të së drejtës (**fonte di produzione**); kjo ka të bëjë me identifikimin e organeve dhe subjekteve që janë kompetentë apo të autorizuar për të krijuar (prodhuar) norma, siç janë, ta zëmë, parlamenti apo qeveria, organi i njësisë federale, subjektet individuale (palët kontraktuese në bazë të lirisë së kontraktimit, krejt anëtarët e shoqërisë, shoqatave dhe asociacioneve (kur bëhet fjalë për zakonin) dhe kështu me radhë;
- burimet e njohjes të së drejtës (**fonte di cognizione**); kjo ka të bëjë me aktin ose dokumentin që përmban normat juridike dhe mund të ketë formën formalo-juridike të ligjvënësit (ligji), rregullativës ose akteve të tjera qeveritare (rregulloret për zbatim të ligjit ose dekrete me fuqi ligjore, kur ekzekutivi në mënyrë primare i normon marrëdhëniet e caktuara gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, vendimet dhe aktet tjera të pushtetit ekzekutiv), ose mund të jetë sjellje krejt e thjeshtë njerëzore (zakoni); dhe, së fundi,
- burimet e elaborimit të së drejtës (**fonte di elaborazione**); kjo ka të bëjë me procesin e krijimit të normave juridike, të cilave rendi juridik ua njeh cilësinë e burimit të së drejtës; kushtetuta ose zakonet njohin të drejtën organeve dhe individëve të caktuar për të formuluar norma juridike, me kusht që respektohen kufizimet dhe forma e përcaktuar.

Këto tri kuptime të burimeve të së drejtës, në fakt, flasin për tri cilësitë e aktit juridik. Ato janë: dhënësi (miratuesi) i aktit, forma e aktit dhe procedura e miratimit (krijimit) të aktit. Kjo si më sipër, megjithatë, nuk do të thotë se autori ka braktisur ndarjen tradicionale në burime materiale dhe burime formale. Përkundrazi, në mënyrë standarde, ai sqaron se të llojit të parë janë forcat shoqërore që krijojnë të drejtën, për shkak të të cilave e drejta ka përmbajtjen që ka, kurse të dytat i referohen formave në të cilat shprehen (manifestohen) aktet e përgjithshme juridike që përmbajnë norma të përgjithshme juridike. Për më tepër, në mënyrë të vendosur, konfrom traditës së pozitivizmit evropian të gjysmës së dytë të shekullit XIX, ky autor konstaton se vetëm aktet e përgjithshme juridike mund të jenë burim i së drejtës, sepse vetëm nga to rrjedh (buron) rregulla e sjelljes pa marrë parasysh sa herë zbatohen në praktikë aktet e tilla. Aktet individuale, ndërkaq, me zbatimin e tyre në një rast apo mosmarrëveshje konkrete, pushojnë se qeni në kuptimin juridik, sepse detyrueshmëria e tyre shteret (mbyllet) me zbatimin e tyre në zgjidhjen e një rasti apo mosmarrëveshjeje konkrete.[260]

Autori me plotë të drejtë konstaton se, hierarkia dhe klasifikimi sistematik i burimeve të së drejtës në përgjithësi, të drejtës kushtetuese në veçanti, merr kuptim vetëm në sistemin kontinental të kushtetutës së shkruar, e cila në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse kodifikon marrëdhëniet kushtetuese. Në sistemin jokontinental (sistemi i të drejtës së përgjithshme) vlen kriteri i kushtetutës së pashkruar apo i burimeve materiale të së drejtës kushtetuese, që nënkupton se e drejtë kushtetuese është jo vetëm ajo që prodhohet nga ligjvënësi, por edhe çdo prodhim tjetër juridik që për objekt normimi ka marrëdhëniet e materies kushtetuese. Në kuptimin formal, ndërkaq, ajo çfarë ngelet jashtë tekstit të kushtetutës së shkruar, nuk do të thotë se nuk përfaqëson burim të drejtës kushtetuese. Ato gjenden edhe jashtë tekstit themelor që ka formën me shkrim dhe që kodifikon marrëdhëniet kushtetuese në mënyrën më gjithëpërf-

258 Ratko Marković*,* U*stavno pravo i političke institucije*, 19.
259 Ibid., fq. 19.
260 Ratko Marković*,* U*stavno pravo i političke institucije* fq. 19-20.

shirëse. Prandaj, në sistemin kontinental çdo herë nevojitet një klasifikim i burimeve të së drejtës sipas fuqisë së tyre juridike, në ndërkohë që përpilimi i listës së burimeve të së drejtës kushtetuese nuk bazohet në fuqinë juridike të normave juridiko-kushtetuese, por në materien që rregullojnë normat e sjelljes që gëzojnë mbrojtjen e aparatit shtetëror – normat juridike. Pa këtë qasje, studimi dhe hulumtimi i të drejtës kushtetuese të vendeve që modelohen sipas sistemit juridik-kushtetues britanik, do të ngelte jashtë. Një listim të tillë të burimeve, që nuk bazohet vetëm në fuqinë juridike por në krejt materien kushtetuese, pa marrë parasysh formën e manifestimit të saj, e gjejmë te **Ratko Markoviq**, ani se fjalën "listë" e fut në thonjëza, për të treguar se listimi i saktë nuk mund të përpilohet asnjëherë: [261]

- kushtetuta dhe ligjet kushtetuese (të shtetit federal dhe njësive federale);
- ligjet e parlamentit (të shtetit federal dhe njësive federale);
- ligjet e deleguara (ligjet që nuk kanë për autor parlamentin, të miratuara në bazë të autorizimit të deleguar nga parlamenti);
- dekret-ligjet (aktet e pushtetit ekzekutiv me fuqi ligjore);
- rregulloret dhe vendimet e pushtetit ekzekutiv;
- rregullorja parlamentare;
- zakonet dhe konventat kushtetuese;
- vendimet e gjykatave kushtetuese.

Autori si më sipër, megjithatë, askund në librin e tij nuk flet në mënyrë specifike për burimet e së drejtës kushtetuese në Serbi. Disa prej burimeve të listuara, siç janë zakonet dhe konventat kushtetuese, i referohen sistemeve juridike të së drejtës së përgjithshme dhe nuk gjejnë zbatim në Serbi (njëjtë si në vendet tjera në rajon). Për këtë arsye nga lista mungojnë statutet e komunave, përfshirë statuti i autonomisë politiko-territoriale të Vojvodinës, provincë në veri të Serbisë, në ndërkohë që në burime të së drejtës kushtetuese janë futur ligjet e deleguara, që nuk figurojnë si burim i së drejtës kushtetuese në Serbi. Diskutimin e burimeve të së drejtës kushtetuese në Serbi, si dhe listimin e tyre, e bëri një autor tjetër, **Slobodan P. Orloviq**, duke mbështetur klasifikimin e burimeve të së drejtës kushtetuese serbe në burimet ekzistuese pozitive të së drejtës kushtetuese.[262] Këtë klasifikim, krejt natyrshëm, ky autor e nis me **Kushtetutën e Serbisë** (KSerb), aktualisht në fuqi nga viti 2006. **KSerb** deri më sot nuk është ndryshuar dhe, krahas saj, është miratuar edhe një ligj kushtetues për vënien e saj në jetë në fazën transitore. Sipas stipulimit shprehimor dhe standard, KSerb është akti më i lartë në vend (neni 194 parag. 2 i **KSerb**).

Ligjet, për dallim nga **KSerb** dhe ligji kushtetues, që çdo herë janë burime themelore dhe të drejtpërdrejta të së drejtës kushtetuese, konsiderohen burime të së drejtës kushtetuese vetëm për aq sa rregullojnë materien kushtetuese. Si të tilla janë burime plotësuese të së drejtës kushtetuese dhe duhet të jenë në harmoni me **KSerb** dhe nuk guxojnë të jenë kundër marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare dhe normave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.[263] Në ligjet që janë burim i të drejtës kushtetuese në Serbi, autori **Slobodan P. Orloviq** llogarit grupin e ligjeve për organet e pushtetit (Kuvendin, Qeverinë, Presidentin, Gjykatën Kushtetuese, Avokatin e Popullit, vetëqeverisjen lokale, kompetencat e Krahinës Autonome të Vojvodinës, gjyqësorin serb, Prokurorinë), ligjet që rregullojnë materien zgjedhore (ligji mbi zgjedhjen e deputetëve, ligji mbi zgjedhjen e Presidentit, ligji mbi zgjedhjet lokale, ligji mbi listat zgjedhore, ligji mbi referendumin dhe iniciativën popullore) dhe, në fund, ligjet për të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve (ligjet: mbi liritë dhe të drejtat e minoriteteve, pengimin e diskriminimit të personave me invaliditet, ndalimin e diskriminimit, barazinë e gjinive, shtetësinë, këshillat nacionale të pakicave kombëtare, përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve).[264]

[261] Ratko Marković, U*stavno pravo i političke institucije*, fq. 20.
[262] Slobodan P. Orlović, *Ustavno pravo*, fq. 34-37.
[263] Neni 16.2 i **KSerb.**
[264] Slobodan P. Orlović, *Ustavno pravo*, fq. 35.

Edhe në Serbi, **aktet nënligjore** që rregullojnë materien kushtetuese paraqesin burim plotësues të së drejtës kushtetuese. Këto **Slobodan P. Orloviq** i përmbledh në disa grupe: rregullativa për zbatimin e ligjeve,[265] rregulloret mbi punën e organeve të pushtetit,[266] statutet dhe vendimet e krahinave autonome[267] dhe njësive të vetëqeverisjes lokale[268] dhe, në fund, aktet e përgjithshme të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. [269]

Sa i përket kriterit origjinës gjeografike të burimeve të së drejtës kushtetuese, dy lloje të burimeve të së drejtës ndërkombëtare njihen në rendin kushtetues serb: rregullat përgjithësisht të pranuara të së drejtës ndërkombëtare dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare. Dy këto burime konsiderohen burime të së drejtës kushtetuese vetëm për aq sa rregullojnë materien e caktuar kushtetuese. Sipas përcaktimit shprehimor kushtetues, këto janë pjesë e rendit juridik të **Serbisë**, kur normojnë materien e lirive dhe të drejtave të njeriut – zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë (nenet 18 parag. 2 dhe 194 parag. 4 & 5 i **KSerb**). Këtu bëhet fjalë për burime të së drejtës që nuk kanë fuqi të njëjtë juridike: rregullat përgjithësisht të pranuara të së drejtës ndërkombëtare kanë karakterin e normave kushtetuese dhe, në rendin kushtetues serb, Gjykata Kushtetuese (GJKSerb) nuk ka juridiksion për kontroll të kushtetutshmërisë së tyre. Ligjet nuk mund të jenë në kundërshtim me rregullat në fjalë (neni 194 parag. 4 i KSerb). Marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare, ndërkaq, duhet të jenë në pajtim më **KSerb** (në fakt, në nenin 194 parag. 4, **KSerb** thotë se ato nuk guxojnë të jenë në kundërshtim me të).

Në nenin 166 parag. 1 të KSerb përdoret pak a shumë formulimi i njëjtë sa i përket natyrës juridike të vendimeve të **GJKSerb**: ato janë përfundimtare, të ekzekutueshme dhe të detyrueshme për të gjithë. Lidhur me këtë, **Slobodan P. Orloviq** bënë dallimin në mes të vendimeve që jepen në procedurën e kontrollit abstrakt të normës juridike dhe vendimeve që jepen në procedurën sipas ankesave kushtetuese. Në rastin e parë, ato mund të kenë pasoja për burimet e së drejtës sepse ligji i shpallur jokushtetues, apo pjesë të tij, nxirren jashtë përdorimit dhe më nuk mund të rregullojnë marrëdhëniet në mes të subjekteve të së drejtës. Në rastin e dytë, ndërkaq, vendimi i GJKSerb ka rëndësi të gjerë për burimet e së drejtës kushtetuese për shkak se organet tjera shtetërore domosdo ndikohen nga arsyetimi i dhënë i gjyqtarëve kushtetues. Për vendimet e gjyqësorit të rregullt, autori nuk ka asnjë dilemë se ato nuk janë burim i së drejtës kushtetuese për shkak të natyrës së gjyqësorit të tillë. Mendim të njëjtë ka edhe për zakonin kushtetues, i cili, gjithnjë sipas tij, nuk ekziston në rendin juridik serb. Një rëndësi teorike, megjithatë, ua njeh zakoneve kushtetuese sepse mund të shërbejnë për plotësim të zbrazëtive juridike dhe për interpretim të normave joprecize kushtetuese, duke hapur

---

265 Rregulloret e Qeverisë për zbatimin e ligjeve janë burim i të drejtës kushtetuese atëherë kur normojnë materien kushtetuese. Në mënyrë të posaçme janë burim i të drejtës kushtetuese akatet e pushtetit ekzkeutiv, Qeverisë dhe Presidentit të republikës, me të cilat rregullohet regjimi i lirive dhe të drejtave të njeriut gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme, si dhe aktet e presidentit të Republikës, kryetarit të Qeverisë dhe kryetarit të Kuvendit gjatë kohës së gjendjes së luftës. Slobodan P. Orlović, *Ustavno pravo*, fq. 35.

266 Në mesin e rregulloreve mbi punën e organeve të pushtetit, burim më i rëndësishëm i të drejtës kushtetuese është rregullorja e Kuvendit të Serbisë. Krahas saj, duhet të përmenden edhe rregulloret e Qeverisë, Gjykatës Kushtetuese, Komisionit Qendror Zgjedhor dhe rregullorja e Gjyqësorit (dmth në nivel të krejt gjyqësorit të rregullt serb, ekziston një rregullore). Ibid., fq. 35.

267 Në preambulë, parimet themelore (neni 12) dhe në pjesën operative (nenet 176-187), KSerb flet për autonominë krahinore. Krahas **Vojvodinës**, aty e fut edhe **Kosovën** (të cilën e quan "Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë", një cilësim ky shovinist dhe përbuzës për shqiptarët). U muar vesh kjo është absurd i llojit të vet.
Krahina e Vojvodinës, ndërkaq, prodhon akte juridike që kanë rëndësi kushtetuese për fqinjin tonë verior. Statuti është akti më i lartë i **Krahinës Autonome të Vojvodinës**. Statuti duhet të jetë në pajtim më KSerb dhe ligjin, rregullon materie të caktuar statutore dhe shërben si një burim specifik i të drejtës kushtetuese.
Akte të tjera nënligjore si burime të së drejtës kushtetuese në **Krahinën e Vojvodinës** janë vendimet e **Kuvendit të Vojvodinës** (mbi zbatimin e Statutit të Krahinës së Vojvodinës, Kuvendin e Krahinës së Vojvodinës, Qeverinë Krahniore, administratën krahinore, Avokatin e Popullit, zgjedhjen e deputetëve për Kuvendin e Krahinës së Vojvodinës, mbi dukjen dhe përdorimin e simboleve dhe simboleve tradicionale të Krahinës së Vojvodinës dhe mbi barazinë e gjinive). Ibid., fq. 35-36.

268 Këtu bëhet fjalë për statutet e komunave, qyteteve dhe qytetit të **Beogradit**. Ibid., fq. 36.

269 Nga aktet e Komisionit vlen të veçohen si burime të së drejtës kushtetuese serbe, si vijon: rregullat mbi punën e këshillave zgjedhor, udhëzimet për zbatimin e zgjedhjeve për deputetë të Kuvendit të Serbisë, Presidentin e republikës dhe për kryerjen e zgjedhjeve në **Kosovë**. Këto dipsozita, miratohen çdoherë pas shpalljes së zgjedhjeve, dmth janë të reja në secilin cikël zgjedhor. Ibid., fq. 36.

rrugë kësisoj për shndërrimin e tyre në burime formale kushtetuese në të ardhmen.[270]

6. Miratimi dhe ndryshimi i kushtetutës

Shtetet e sotme domosdo që kanë një kushtetutë, e cila shërben si dëshmi e pjekurisë politike të një shoqërie të organizuar në shtet. Në pjesën dërmuese, shtetet e krijuara në dy shekujt e fundit kanë miratuar kushtetutat e tyre. Jo të gjitha fuqitë e mëdha të kësaj kohe, megjithatë, kanë bërë një gjë të tillë. Perandoritë otomane[271] dhe ruse,[272] ta zëmë, nuk kanë pasur një kushtetutë. Edhe kur i kanë pasur, ato nuk qenë jetëgjatë dhe nuk kanë shërbyer si kufizuese efektive të pushtetit absolut të perandorëve, që kanë vazhduar të ngelin suprem. Në fakt, vetë kushtetutat e këtyre dy perandorive kanë qenë kushtetuta të dhuruara, nga mëshira e perandorëve otomanë dhe rusë respektivisht, që kanë vazhduar sundimin e tyre sipas modelit të vjetër absolutist, por tani të veshur me petkun kushtetues.

Shtetet **paramoderne** nuk kanë pasur kushtetutë, por e kanë organizuar pushtetin. Baza juridike e organizimit të një pushteti të tillë, përfshirë vetë origjinën, nuk ka qenë kushtetuta, siç është sot, por **e drejta hyjnore**. Sundimtarët janë konsideruar përfaqësues të Zotit në tokë, si sovranë kanë qenë bartës të pushtetit më të lartë shtetëror. Kjo ndryshon në fund të shekullit XVIII, kur borgjezia liberale dhe qytetaria e qendrave urbane, së bashku me segmente të tjera shoqërore, përmes luftës politike synojnë kornizimin juridik të fitoreve të arritura në planin e kufizimit të pushtetit absolut të deriatëheréshëm të monarkëve evropianë, kurse përtej Atlantikut kufizimi i pushtetit shtetëror u shtrua në dritën e luftës për pavarësi të ish-kolonive britanike. Në fillim në numër të vogël, dy sosh në fund të shekullit në fjalë, në shekullin në vijim kushtetutat do të bëhen standard dallues i qytetërimit perëndimor, me të cilat shpesh edhe në mënyrë solemne, bëhet kufizimi i pushtetit monarkik të pakufizuar deri në atë kohë. Në të shumtën e rasteve ato u miratuan, kryesisht nën ndikimin francez që u përhap me pushtimet e **Napoleonit** (Napoleon Bonaparte: 1769-1821). Kishte raste, megjithatë, kur u bë dhurimi i tyre nga ana e kurorës mbretërore, siç ishte **Karta Kushtetuese Franceze** (1814), që u dhurua nën presionin e faktorit ndërkombëtar të kohës.[273] Si në rastin e parë ashtu edhe në të dytin, krijimi i kushtetutave u përgatit nga paraqitja dhe imponimi i qëndrimeve politike mbi nevojën për kushtetutë, me të cilën do të rregullohej pushteti, origjina dhe funksionimi i tij, si dhe liritë dhe të drejtat njerëzore. Këtë paraqitje imponuese të qëndrimeve politike mbi nevojën e krijimit të një kushtetute e kanë bërë përfaqësuesit e grupeve dhe shtresave të ndryshme shoqërore, liderët politikë dhe ushtarakë, mendimtarët e drejtësisë dhe filozofët.[274]

---

270 Slobodan P. Orlović, *Ustavno pravo*, fq. 37.

271 Kushtetuta e **Sulltan Abdylhamidit të Dytë** (Sultan Abdul Hamid II: 1842-1918) ka qenë në fuqi nga viti 1876 deri në vitin 1878. Kjo kohë ndryshe njihet si **periudha e parë kushtetuese**. E dyta nis me **Xhonturqit**, në vitin 1908, pas revolucionit të tyre të atij viti, dhe përfundon në vitin 1922.

272 **Kushtetuta e Rusisë** e vitit 1906 ka të bëj me rishikimin e ligjeve ekzistuese të vitit 1832, të njohur si **Ligjet Fundamentale të Perandorisë Ruse**, të cilat mëtuan të transformojnë shtetin absolutist rus në një shtet ku perandori u pajtua për herë të parë, njëjtë si në rastin otoman, për të ndarë formalisht pushtetin autokratik me parlamentin që ka përbërje që reflekton shtresat kryesore shoqërore, aristokracinë dhe klerin.

273 **Karta Kushtetuese Franceze** ka qenë një tekst kushtetues i dhuruar nga **Mbreti Luigji XVIII i Francës** (Louis XVIII: 1755-1824), mënjëherë pas **Restaurimit Burbon** (rikthimi në fron i dinastisë **Burbon** që ishte përmbysur nga Napoleoni). **Kongresi i Vjenës**, klubi i shteteve fitimtarë ndaj Napolonit, plus Franca, kërkuan nga Luigji XVIII që të hartonte një kushtetutë para se të restaurohej në fron të dinastisë Buron, së cilës i takonte.

274 Ndër autorët më me ndikim në këtë kuptim në **Evropë** kanë qenë **Abati Sijes**, **Benjamin Konstant** (Benjamin Constant: 1767-1830), kurse matanë Atlantikut autorët e **Letrave të Federalistit** (The Federalist Papers: 1788). Në të vërtetë kanë qenë **Letrat e Federalistit** ato që kanë pasur një influencë të madhe në **Francë** dhe vendet tjera evropaine pas Revolucionit Francez të vitit 1789 dhe më pas, deri në ditët e sotme.
Dy revolucionet, ndërkaq, kanë qenë të ndikuara nga filozfë me bindje dhe botëkuptime të ndryshme: ai në Amerikë u ndikua fuqishëm nga idetë liberale të **Xhon Llokut**, kurse ky në **Francë** në idetë e **Zhan Zhak Rusosë** mbi **vullnetin e përgjithshëm**, që përfaqësohet nga populli, i cili bën ligje të mira dhe kurrë nuk gabon. Ajo që u qujat **vullnet i përgjithshëm**, u bë standard i kushtetutës franceze, por që me kalimin e kohës, nën ndikimin e fuqishëm të ideve të **Abatit Sijes** dhe **Benjamin Konstant**, u korrigju me mekanizma kontrollues dhe balancues, për të menjanuar tiraninë e vullnetit të përgjithshëm të vullnetit të shumicës. Ideja se parlamenti mund të ishte reprersiv dhe jodemokratik kishte lindur, në fakt, qysh në kohën e **Oliver Kromuelit** (Oliver Cromwell: 1599-1658) dhe "Parlamentin e Gjatë" që ai e ndërtoi, si një instrument për të përligjësuar diktaturën e tij.

Edhe në kohët e sotme, me rastin e nxjerrjes apo ndryshimit të kushtetutës, manifestohen dhe kryqëzohen qëndrimet politike nëpër debate të organizuara, të cilat quhet **shqyrtime publike.** Në to marrin pjesë partitë politike dhe qytetarët, intelektualët dhe grupet e ndryshme të interesuara. Këto shqyrtime duhet të zgjasin mjaftueshëm për të lënë mundësinë që qytetarët dhe opinioni publik të shprehin pikëpamjet e tyre të arsyetuara lidhur me kushtetutën e re apo ndryshimin e asaj ekzistuese. Kjo është e domosdoshme sepse vetëm në atë mënyrë trupa zgjedhore, drejtpërdrejt ose përmes përfaqësuesve të zgjedhur në parlament, legjitimon kushtetutën e re ose atë të ndryshuar. Rrugët tjera janë jolegjitime.

Procedura kushtetutëbërëse përbëhet prej **veprimeve faktike** dhe **veprimeve juridike.** Të llojit të parë janë veprimet që përgatisin qytetarët dhe opinionin publik për kushtetutë, që mund të jetë kushtetutë e re bazuar në kushtetutën ekzistuese, kushtetutë **ab nihilo** (që lind nga hiçi juridik, gjendje së cilës i paraprinë një **grundnormë** që krijon një entitet të ri politik që quhet shtet, kurse vetë **grundnorma** zakonisht quhet deklaratë mbi pavarësinë apo ngjashëm më këtë) dhe, së fundi, amendamentim i kushtetutës ekzistuese. Veprimet juridike, ndërkaq, fillojnë me nisjen e procedurës së kushtetutëbërjes, përpilimin e draftit të kushtetutës dhe votimit mbi të. Veprimet juridike për krijimin e kushtetutës së re (qoftë bazuar në kushtetutën ekzistuese apo **ab nihilo**) dhe veprimet juridike për amendamentimin e kushtetutës ekzistuese, sipas rregullit janë të njëjta. Në disa shtete, megjithatë, bëhet dallim në mes tyre, si p.sh. **Bullgaria**[275] dhe **Zvicra**.[276]

Pushteti që krijon kushtetutën quhet **pushtet konstituiv** dhe ka dy trajta themelore.[277] Këto i kemi diskutuar më lartë në seksionin 4.3., në kontekstin e burimeve të së drejtës kushtetuese. Trajta e parë është **pushteti konstituiv origjiner** dhe ka të bëj me miratimin e kushtetutës për herë të parë, pa pasur asnjë bazë juridike paraprake, pra **ab nihilo** me rrugë **extra constitutionem**, duke u bazuar në një **grundnormë** origjinale (vendim politik mbi llojin dhe formën e ekzistencës politike të një populli, me çka nënkuptohet në rend të parë dhe mbi të gjitha vendimi politik mbi llojin e shtetit dhe formën e qeverisjes). Trajta e dytë është **pushteti konstituiv derivativ**, që poashtu mund të ketë dy nëntrajta të tij: e para është pushteti për amendamentim (ndryshim) kurse e dyta pushteti për rishikim (revidim). Në rastin e pushtetit për amendamentim

---

275 Në kapitullin nëntë (nenet 153-163) të **Kushtetutës së Bullgarisë** (1991) rregullohen ndaras amendamentimi i kushtetutës dhe miratimi i kushtetutës së re. Vetë titulli i këtij kapitulli, në fakt, reflekton këtë gjë: "Amendamentimet në Kushtetutë" (fjalia e parë e kapitullit të nëntë) dhe "Miratimi i Kushtetutës së re " (fjalia e dytë e kapitullit nëntë). Cf. **CONSTITUTION OF THE REPUBLIC OF BULGARIA** Prom. SG 56/13 Jul 1991, amend. SG 85/26 Sep 2003, SG 18/25 Feb 2005, SG 27/31 Mar 2006, SG 78/26 Sep 2006- Constitutional Court Judgment No.7/2006, SG 12/6 Feb 2007. Në internet: https://www.parliament.bg/en/const (shikuar në mars 2022).

276 Në kapitullin e parë të titullit të 6 që flet për rishikimin e Kushtetutës federale dhe dispozitat transitore, Kushtetuta e Zvicrës (1999) bën dallimin në mes të rishikimit të pjesëshëm dhe rishikimit të plotë. Në rastin e parë bëhet fjalë për amendnamentim kurse në të dytin për nxjerrjen e një kushtetute krejtësisht të re bazuar në dispozitat e kushtetues ekzistuese, pra jo **ab nihilo.** Cf. **Federal Constitution of the Swiss Confederation** of 18 April 1999 (Status as of 7 March 2021). Në internet: https://www.fedlex.admin.ch/eli/cc/1999/404/en (shikuar në mars 2022).

277 Në gjuhën shqipe **pushteti konstituiv** përkthehet si pushtet **kushtetutëbërës** dhe **kushtetutëvënës** njëkohësisht dhe është përkthim i fjalpërfjalshëm i fjalëve serbe "ustavotvorna vlast" dhe "ustanovljajuca vlast". Cf. Slobodan P. Orlović, *Ustavno pravo*, 38.Në gjuhën shqipe, megjithatë, nuk mund të përdoret veçse shprehja **kushtetutëbërja**, duke braktisur dy shprehjet tjera që hasen nganjëherë aty-këtu – **kushtetutëvënia** dhe **kushtetutëdhënia**. Emërues i përbashkët i të gjitha shprehjeve si më sipër është **pushteti konstituiv** (në të gjitha trajtat e nëntrajtat e sqaruara këtu nga ana jonë). Në fakt, ideja e përdorimit të fjalëve **pushtetit konstituiv** dhe **kushtëtubërje** reflekton përmbajtjen e tyre në konstitutcionalizmin liberal perëndimor, ku norma kushtetuese nuk mund të lind përmes procesit të **normavënies** e as të **normadhënies**, por përmes procesit **normabërës** (Angl.: "norm-making", që përfshinë "constitution-making" dhe "law-making"; kjo e fundit përfshinë jo vetëm ligjin si akt që miratohet nga parlamenti, por cdo aktivitet shtetëror që prodhon norma të përgjithshme juridike), që krijohet sipas një pushteti që ka natyrë konstituive, qoftë origjinere apo derivative. E njëjta vlen edhe për **kushtetutëbërjen** (Angl.: "constitution-making") që rezulton si pasojë e ushtrimit të **pushtetit konstituiv** (origjiner ose derivativ), dhe **ligjbërjen** (Angl.: "law-making", që nënkupton mbi të gjitha ligjin si akt formal, por, siç u tha, edhe trajtat tjera të manifestimit të normabërjes me karakter të përgjithshëm). Në dy rastet bëhet fjalë përshkrim të procesit të ushtrimit të një **pushteti konstituiv**, në trajtën e tij origjinere apo derivative, jo për përshkrim të dhënies apo vënies së strukturave normative (kushtetuese, ligjore dhe të tjera) nga një subjekt. Shprehjet normadhënie dhe normavënie zakonisht kanë të bëjnë me kurorat mbretërore, dhe përshkruajnë periudhën e historisë kushtetuese evropiane kur kurora mbretërore ka qenë pushtet konstituiv legjitim, me origjinë hyjnore. Këto dy shprehje, përveç kurorës, mund të përshkruajnë edhe një forcë tjetër shoqërore që operon jashtë vullnetit të sovranit dhe përfaqësuesve të tij, që qëndron mbi ata me të cilën kanë të bëjnë strukturat e tilla normative. Këtu kemi parasyshë diktatorët dhe pushtetuesit e ndryshëm të popujve të tjetër, autokracitë e çfarëdo lloji e forme dhe kështu me radhë.

bëhet fjalë për atë që disa kushtetuta, si ajo bullgare dhe zvicerane (por edhe kushtetutat e **Austrisë**,[278] **Kostarikës**[279] dhe **Spanjës**[280]) e cilësojnë si rishikim i pjesshëm, kur ndryshohet vetëm një pjesë e kushtetutës ekzistuese, kurse në rastin e pushtetit për rishikim (revidim) zakonisht bëhet fjalë për miratim të kushtetutës së re, por duke u bazuar në procedurat dhe kushtet e përcaktuara më një kushtetutë ekzistuese. Sikundër u pa në rastin austriak, bullgar, zviceran, spanjoll, kostarikan, por edhe në raste të tjera që këtu nuk shtjellojmë, kjo cilësohet si **rishikim i tërësishëm**.

Në dy situatat e ushtrimit të **pushtetit konstituiv derivativ**, pra, bëhet fjalë për prodhim të normave kushtetuese duke u bazuar në një kushtetutë ekzistuese, që përcakton kushtet dhe procedurat për një gjë të tillë. Një gjë e tillë nënkupton edhe mundësinë për ndryshim të procedurave dhe kushteve të prodhimit të normave të një kushtetute ekzistuese. Në një rast të tillë sërish bëhet fjalë për ushtrim të pushtetit konstituiv derivativ. Ndryshimi i procedurës dhe kushteve ekzistuese për prodhim të normave kushtetuese, megjithatë, nuk nënkupton medoemos se rezulton në krijim (miratim) të një kushtetute tjetër të re. Kjo sepse ai ndryshim i procedurës dhe kushteve mund të çoj në rishikim të pjesshëm të pjesës tjetër operative të kushtetutës. Kjo është kështu edhe për faktin se në rastin e rishikimit të tërësishëm, akoma mund të ngelin në fuqi dispozitat kushtetuese mbi procedurën dhe kushtet e rishikimit, që kanë fuqinë e njëjtë me dispozitat e reja kushtetuese nga pjesa tjetër e kushtetutës. Kur nuk ngelin, pra kur ndryshon edhe procedura dhe kushtet e rishikimit për të ardhmen, atëherë bashkë me të mund të prodhohet (miratohet) një kushtetutë tërësisht të re, por që sërish konsiderohet se ka lindur sipas procedurës kushtetuese ekzistuese, në vijim të ushtrimit të pushtetit konstituiv derivativ si më sipër. Kur ky nuk është rasti, sikundër u tha më lartë, pra kur kushtetuta e re lind **ab nihilo** dhe me rrugë **extra constitutionem**, atëherë bëhet fjalë për ushtrim të **pushtetit konstituiv origjiner**, jo për rishikim kushtetues (qoftë i pjesshëm apo i tërësishëm).

Nga sa më sipër rrjedh se ekzistojnë këto lloje të normave kushtetuese që prodhohen si rezultat i ushtrimit të pushtetit konstituiv (origjiner dhe derivativ): kushtetuta e parë dhe kushtetutat që prodhohen pas saj dhe amendamentet kushtetuese. Sikundër shpjeguam më sipër te seksioni mbi burimet e të drejtës kushtetuese, nuk mund të ketë dallim sa ai përket fuqisë juridike në mes të kushtetutës si tekst integral dhe amendamenteve kushtetuese: i vetmi dallim në fuqi juridike ekziston më mes të **klauzolave të përjetësisë** apo **dispozitave të paamendamentueshme kushtetuese**.

6.1. Procedura e miratimit dhe ndryshimit të kushtetutës

Lidhur me miratimin dhe ndryshimin e kushtetutës mund të shtrohet një pyetje fillestare: pse bëhet ndryshimi i kushtetutës ekzistuese dhe pse krijohet një kushtetutë e re? Kushtetuta është akti më i lartë juridik. Mbi të qëndron krejt ngrehina e të drejtës pozitive. Për këtë arsye, ajo duhet të jetë në pajtim dhe të reflektojë ndryshimet në shoqëri – politike, ekonomike, teknologjike dhe të tjera ndryshime. Me rishikim të

[278] Në nenin 44.3 të **Kushtetutës së Austrisë** (1920), aktualsiht në fuqi, bëhet fjalë për rishikimin e pjesëshëm dhe rishikimin e tërësishëm të saj. Cf. **Austria's Constitution of 1920, Reinstated in 1945, with Amendments through 2009.** Në internet: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/ viewer.html?pdfurl=https%3 A%2F%2Fwww.constituteproject.org %2Fconstitution%2FAustria_2009.pdf (shikuar në mars 2022).

[279] Titulli i dhjetë (nenet 195-196) i **Kushtetutës së Kosta Rikës** titullohet "Reforma kushtetuese" dhe rregullon reformën e pjesëshme (e cila kryhet nga Asamleja Legjislative) dhe reformën e tërësishme (e cila mund të kryhet vetëm nga Asambleja Kushtetuese e thirrur për një gjë të tillë). Cf. **Costa Rica's Constitution of 1949 with Amendments through 2011**. Në internet: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/ viewer.html? pdfurl=https%3A%2F%2Fwww.constituteproject.org%2Fconstitution%2FCosta_Rica_2011.pdf (shikuar në mars 2022).

[280] Pjesa e dhjetë e **Kushtetutës së Spanjës** (1978) titullohet "Amendamentimi kushtetues" (nenet 166-169). Aty, megjithatë, nuk bëhet dallimi në mes të prodhimit të normave kushtetuese sipas procedurës për amendamentim dhe procedurës për rishikim kushtetues. Në rastin e fundit, normohen dy lloje të rishikimit, i pjesëshëm dhe i tërësishëm. Për pikë referimi të dallimit në mes të teknikës së amendamentimit dhe rishikimit kushtetues, si dy mënyra për prodhim të normave kushtetuese në bazë të procedurave dhe kushteve ekzistuese kushtetuese, shërbejnë pjesët kushtetuese që afektohen: në rastin e amendamentimit bëhet fjalë për secilën pjesë të kushtetutës, përveç atyre që preken me rishikim, kurse në rastin e rishikimit bëhet fjalë për afektim të pjesës hyrëse, kapitullit II, divizioni 1 i Pjesës I apo Pjesës II të Kushtetutës. Cf. **Spain's Constitution of 1978 with Amendments through 2011**. Në internet: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/viewer. Html? pdfurl=https%3A%2F%2F-www.constituteproject.org%2Fconstitution%2FSpain_2011.pdf%3Flang%3Den (shikuar në mars 2022).

kushtetutës ekzistuese nuk jepet përgjigja ndaj të gjitha ndryshimeve në shoqëri, por vetëm në ato që janë më të rëndësishme, më themelore, në ndërkohë që të tjerat ndryshime përcillen me ndryshime në **ligje**, të cilat, në anën tjetër, **prezumohet se janë kushtetuese** sepse i venë në jetë (operacionalizojnë) dispozitat konkrete kushtetuese.

Procedura e miratimit dhe ndryshimit të kushtetutës, përkatësisht mënyra e ushtrimit të pushtetit konstituiv (atij pushteti që ndër ne, sikundër u tha, cilësohet si pushtet kushtetutëbërës/kushtetutëvënës, për shkak të ndikimit të terminologjisë kushtetuese në gjuhët sllave) është shumë më e komplikuar se miratimi dhe ndryshimi i ligjeve (ligjbërja/ligjvënia). Nga kjo rrjedh se shumë më vështirë bëhet miratimi dhe ndryshimi i kushtetutës se i ligjit, gjë që nënkupton se kushtetuta më rrallë miratohet dhe ndryshohet krahasuar me ligjin. Këto dallime të natyrës procedurale bien në sy kur bëhet fjalë për organin që miraton kushtetutën dhe ndryshimet e saj, procedurën (shumë më vështirë vihet në lëvizje në krahasim me procedurën e prodhimit dhe ndryshimit të ligjeve) dhe, së fundi, shumicën e kërkuar, përfshirë pjesëmarrjen e popullit në miratim të kushtetutës apo ndryshim të saj (në disa vende). Përveç këtyre, kushtetuta pas krijimit (miratimit) nuk mund të ndryshohet çdo herë dhe në çdo kohë. Kushtetutat bashkëkohore, zakonisht përcaktojnë shumë qartë se nuk mund të ndryshohen në kohë të gjendjes së jashtëzakonshme (luftë, fatkeqësi natyrore dhe çdo rrethanë tjetër që krijon nevojë të domosdoshme) dhe as para se të kalojë një periudhë e caktuar kushtetuese nga dështimi i fundit për miratim (të kushtetutave si tërësi apo ndryshimeve në to; në rastin kur bëhet fjalë për miratimin e kushtetutës së parë, pra për ushtrimin e pushtetit konstituiv origjiner për herë të parë, atëherë nuk vlen kjo rregull, sepse ai pushtet ushtrohet **extra constitutionem** nga hiçgjë).

Ka mjaft kushtetuta që, në vijim të diskutimit të procedurës për miratim të kushtetutës dhe ndryshimeve në të, nuk lejojnë fare mundësi për ndryshim në pjesë të caktuara. Thjeshtë, me kushtetutën e parë disa dispozita të saj shpallen si të paamendamentueshme (nuk mund të ndryshohen në asnjë rrethanë). Kjo doktrinë, doktrina kushtetuese mbi **klauzolat e përjetësisë** apo **amendamentet kushtetuese kundërkushtetuese**, u diskutua më sipër (në kuadër të burimeve të së drejtës kushtetuese). Këtu është vendi për shtjellim të saj më gjerësisht dhe nga një kënd tjetër – këndi i procedurës për miratim dhe ndryshim të kushtetutës. Siç mund të kuptohet, këtu zakonisht bëhet fjalë për situatën pas ushtrimit të **pushtetit konstituiv origjiner**, pra pas krijimit (miratimit) të kushtetutës së parë, në të cilën mishërohen disa dispozita kushtetuese që përmbajnë klauzola që tregojnë se cilat pjesë të kushtetutës më nuk do të mund të ndryshohen asnjëherë në të ardhmen. Këto dispozita me këto klauzola duhen dalluar nga rasti i dispozitave kushtetuese që kanë pozitë të privilegjuar, sepse kërkojnë një procedurë të sforcuar, deri në pamundësi, për ndryshim apo abrogim të tërësishëm të tyre. Në rastin e fundit ekziston një mundësi e ndryshimit ose abrogimit të tyre, pa çka se me shumë vështirësi, kurse në rastin e parë nuk mund të bëhet as ndryshimi dhe as abrogimi i tyre në tërësi. Këto të fundit, sidoqoftë, ngjasojnë shumë me klauzolat e përjetësisë, të cilat, teorikisht mund të futen në kushtetutë edhe pas miratimit të kushtetutës së parë, ani pse nuk jemi në dijeni për ndonjë rast të tillë. Kjo është kështu sepse vlerat që sanksionohen me kushtetutë me qëllim konservimi në kohë të pacaktuar përmes **klauzolave të përjetësisë** lindin së bashku me kushtetutën e parë që prodhohet **ab nihilo**.

Përpunimin e parë teorik, doktrina si më sipër e kishte gjetur te juristi gjerman **Karl Shmit**, sikundër u tha më sipër, në kontekstin e diskutimit tonë lidhur me fuqinë juridike dhe hierarkinë e normave kushtetuese. **LTH** i dha shprehjen më të qartë praktike këtij koncepti doktrinar, sipas së cilit disa dispozita nuk do të mund të ndryshoheshin asnjëherë, kurse çdo amendament i propozuar që provon një gjë të tillë, konsiderohet sikur përmban dispozita kushtetuese jokushtetuese. E kemi fjalën për nenet 1 dhe 20 të **LTH,** të cilat përjetësojnë garancionet mbi liritë dhe të drejtat e njeriut dhe parimet mbi karakterin e shtetit dhe pushtetit në **Gjermani**.[281] Këtë praktikë më herët e kanë ndjekur edhe disa vende të tjera, me një intensitet më të vogël, duke ndaluar ndryshimin e formës republikane të qeverisjes, siç është rasti me **Kushtetutën**

[281] Cf. nenet 1 dhe 20 të LTH. **Basic Law for the Federal Republic of Germany. 1949, as amended to 2019**. Në internet: https://constitutions.unwomen.org/en/countries/europe/germany (shikuar në mars 2022).

e Italisë (1947).[282] Më vonë, **Kushtetuta e Francës** (1958) veproi ngjashëm.[283] Në disa raste, kushtetutat shkuan më larg se kaq dhe kombinuan ndalimin kohor të rishikimit të kushtetutës për një kohë të caktuar me klauzolat e përjetësisë. I tillë është përcaktimi i **Kushtetutës së Portugalisë** (1976), e cila ka ndaluar ndryshimet në pesë vitet e pas nxjerrjes së saj dhe, në të njëjtën kohë, ka shpallur si të pandryshueshme një sërë normash kushtetuese, që kanë të bëjnë me si vijon: pluralizmin e organizimit politik, ndarjen e kishës nga shteti, rregullimin unitar, pavarësinë e shtetit, formën republikane të qeverisjes, të drejtat e punëtorëve, pavarësinë e gjyqësorit, autonominë e bashkësive lokale.[284]

Pse kushtetuta miratohet dhe ndryshohet me një procedurë më të vështirë, nganjëherë shumë të vështirësuar, si në aspektin politik ashtu edhe në atë juridik, në krahasim me ligjin? Mbase këtë pyetje mund ta shtrojë ndonjë laik. Për profesionistët e fushës, kjo rrjedh si pasojë logjike e faktit se kushtetuta normon (sanksionon) **materien kushtetuese**, që për objekt ka marrëdhëniet kushtetuese - marrëdhëniet më themelore shoqërore. Sikundër mund të jetë vërejtur nga shtjellimet tona deri këtu, materia kushtetuese në pjesën më të madhe gjenden në kushtetutë, e cila përfaqëson një akt juridik me shkrim që në mënyrë më gjithëpërfshirëse normon marrëdhëniet kushtetuese. E marrëdhëniet kushtetuese janë marrëdhënie themelore shoqërore – marrëdhënie të pushtetit. Kjo është kështu sa i përket kuptimit formal të kushtetutës dhe materies kushtetuese, e cila, gjithashtu normohet edhe me ligje e akte të tjera juridike. Në vendet që nuk kanë një kushtetutë të shkruar që në mënyrë gjithëpërfshirëse normon materien kushtetuese, kjo materie normohet me ligje dhe akte të tjera, zakone e konventa kushtetuese që në mënyrë përkatëse normojnë marrëdhëniet kushtetuese si marrëdhënie themelore shoqërore.

Ajo pjesë e materies kushtetuese që gjendet në kushtetutë përfaqëson materien që ngërthen çështjet më të rëndësishme në shtet: definimin e origjinës dhe natyrës së pushtetit, organizimin dhe funksionimin e tij (përmes caktimit të organeve, juridiksionit dhe kompetencave të tyre themelore), si dhe liritë e të drejtat e njeriut dhe qytetarit në organizimin e pushtetit shtetëror. Kufizimi i pushtetit është i domosdoshëm për realizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit dhe rendit demokratik. Duke pamundësuar ndryshimin e lehtë të çështjeve më të rëndësishme në shtet të normuara me kushtetutë, krijohet një sistem vlerash kushtetuese përmes të cilave mbrohet stabiliteti i rendit juridik dhe kushtetuta ka mundësi të sprovohet në jetë përgjatë një periudhe mjaftueshëm të gjatë kohore.

6.1.1. Miratimi i kushtetutës së parë

Procedura e miratimit të kushtetutës së parë dallon nga procedura e ndryshimit (amendamentimit) të mëvonshëm kushtetues si dhe nga ajo e miratimit të çdo kushtetute tjetër të re të më pastajme. Kjo për shkak se në rastin e miratimit të kushtetutës për herë të parë nuk ekzistojnë rregulla mbi procedurën e kushtetutëbërjes. Në këtë kuptim, kushtetutëbërësit nuk kanë kufizime juridike dhe politikisht janë të lirë për të vendosur se si do të miratojnë kushtetutën e tyre. Kjo liri politike e vendosjes, pa asnjë kufizim juridik, përfshinë tri çështje:

- e para, me çfarë shumice do të miratohet kushtetuta;
- e dyta, i kujt do të jetë propozimi i tekstit të kushtetutës; dhe, së fundi,

[282] Cf. neni 139 i Kushtetutës së Italisë. **Constitution of the Italian Republic**. Në internet: https://www.senato.it › costituzione_inglese (shikuar në mars 2022).

[283] Cf. neni 89 i Kushtetutës së Francës. Në fakt, në këtë nen, përveç që ndalohet çdo amendamentim i formës republikane të qeverisjes, ndalohet nisja apo vazhdimi i procedurës së amendamentimit që rrezikon integritetin territorial të Francës. Atëherë shtrohet pyetja se cili është dallimi në mes këtyre dy përcaktimeve kushtetuese? Në rastin e parë nuk mund të vij fare deri te ndryshimi i formës republikane të qeverisjes, kurse në të dytin duhet një vlerësim paraprak i organeve të shtetit për të vërtetuar nëse bëhet fjalë për rrezikim të integritetit territorial të vendit. **Constitution of France**. Në internet: https://www.refworld.org/docid/3ae6b594b.html (shikuar në mars 2022).

[284] Cf. neni 288 i Kushtetutës së Portugalisë. Në internet: **Portugal's Constitution of 1976 with Amendments through 2005**. Në internet: https://www.constituteproject.org › Portugal_2005 (shikuar në mars 2022).

- e treta, cila do të jetë procedura.

Historia kushtetuese njeh raste kur kushtetutëbërësit kanë konsideruar se po miratojnë një kushtetutë që nuk ka nevojë asnjëherë për amendamentim, ashtu që, për pasojë, nuk kanë paraparë dispozita mbi amendamentim. Në nivel të njëjtë kuptimor janë edhe ndalimet e ndryshimeve kushtetuese për një kohë të caktuar, siç ishte rasti i **Kushtetutës së Portugalisë** si më sipër, apo rasti i parë i këtij lloji, ai i **Kushtetutës së Francës** të vitit 1791, që ndalonte amendamentimin për dhjetë vitet e ardhshme, si dhe ndalimi i amendamentimit të dispozitave të caktuara, të diskutuara më sipër.

Liria politike dhe mosekzistimi i kufizimeve politike ndaj kushtetutëbërësit të parë është në tërësi në pajtim më parimin e sovranitetit popullor, nga i cili rrjedh kushtetuta, sepse një gjeneratë nuk mund të detyroj (të lidhë duart) e gjeneratave të tjera të popullit sovran. Kjo është arsyeja pse edhe "kushtetutat e pandryshueshme" mund të ndryshohen, por jo përmes rrugëve kushtetuese, por me rrugë faktike dhe **extra constitutionem** (me revolucion dhe përmbysje të tjera të thella, radikale, shoqërore). Ky është thelbi i **pushtetit konstituiv origjiner**, bartës i të cilit është popullit sovran, i cili asnjëherë nuk mund të kufizohet juridikisht në pafundësi dhe të privohet nga liria politike për të vendosur për formën dhe përmbajtjen e ekzistencës së vet politike. Dilemën e parë lidhur me dy pikëpamjet e skajshme mbi amendamentimin kushtetuese, asaj që thotë se kushtetuta duhet të ndryshohet orë e çast dhe tjetrës që pohon se ajo nuk duhet të ndryshohet kurrë ose përmes procedurave dhe tejkalimit të barrierave jashtëzakonisht të vështira, ka lindur në Amerikë në debatin e njohur në mes të **Tomas Jeferson** (Thomas Jefferson: 1743-1826) dhe **Xhejms Madison** (James Madison: 1751-1836): i pari, tha se kushtetuta duhet të rinegociohet nga çdo gjeneratë,[285] kurse i dyti kishte frikë se rinegocimi i shpeshtë i çështjeve kushtetuese nga krejt shoqëria do të angazhonte pasionet e rrezikshme njerëzore.[286] Sot e kësaj dite ky lloj debati apo kjo dilemë është aktuale sikur atëherë kur ka lindur: nëse duhet të lejohet fleksibilitet kushtetues për ndryshim apo, e kundërta, të mbyllet dera për ndryshim kushtetues të disa çështjeve, duke i hequr ato nga rinegocimi kushtetues në të ardhmen, janë zgjidhjet që duhet të përqafojnë draftuesit e një kushtetute të parë, zgjidhje që ata e bëjnë si përfaqësues të pushtetit konstituiv origjiner, në përpjekjet e tyre për qëndrueshmëri kushtetuese.[287]

Statusi paraprak juridiko-kushtetues i shtetit që miraton kushtetutën e parë mund të luaj një rol të rëndësishëm në procedurën kushtetuese dhe vetë përmbajtjen e kushtetutës që prodhohet nga një procedurë e tillë. Kjo nënkupton se, shteti duhet të ketë lindur dhe ekzistuar, përkatësisht se kushtetuta nuk krijon shtetin por anasjelltas. Shteti i ri që krijohet vetë përcakton procedurën e miratimit të kushtetutës së vet të parë. Në përmbajtje të kushtetutës, ndërkaq, do të ndikojnë faktet që lidhen me pozitën paraprake politike të shtetit, përkatësisht me pozitën paraprake politike të entitetit para se të bëhet shtet. Kjo është arsyeja pse ish-kolonia jo rrallë shfrytëzon përvojat kushtetuese të metropolës nga e cila pavarësohet, ish-njësia federale që pavarësohet mund të përdorë si model procedurën dhe zgjidhjet kushtetuese nga koha e kushtetutës federale, pjesë e së cilës ka qenë dhe kështu me radhë. Territori që ka qenë pjesë e një shteti tjetër dhe ndërkaq bëhet e pavarur, miraton kushtetutën e vet të parë sipas rregullave kushtetuese vetjake, të cilat do ta obligojnë në të ardhmen. Shtetet e reja çdo herë formohen mbi bazë të përqafimit të një ideologjie të caktuar, ashtu që model kushtetuese për to do të shërbejnë çdo herë kushtetutat e vendeve që tanimë kanë bazë të tillë ideologjike (ideologjia kapitaliste liberale, ideologjia komuniste e proveniencës së caktuar, fundamentalizmi fetar dhe kështu me radhë).

---

285 Thomas Jefferson to James Madison, 6 September 1789 (Paris). Në internet: https://founders.archives.gov/ documents/ Madison/01-12-02-0248 (shikuar në mars 2022).

286 James Madison, *Federalist No. 49*, 5 February 1788 (New York). Në internet: https://founders.archives.gov / documents/ Hamilton/01-04-02-0198 (shikuar në mars 2022).

287 Cf. më shumë për këtë në Silvia Suteu, *Eternity Clauses in Democratic Constitutionalism* (autorja diskuton gjerësisht lindjen dhe ngritjen e klauzolave të përjetësisë në konstitucionalizmin modern, llojin, rolin dhe pozitën e tyre).

6.1.2. Miratimi i kushtetutës së radhës

Në kohën e miratimit të kushtetutës së radhës, ose ndryshimit të kushtetutës ekzistuese, ekzistojnë rregulla mbi procedurën e bërjes së kushtetutës. Pra, në këtë kohë ushtrimi i pushtetit konstituiv ka natyrë derivative sepse bazohet në rregulla të përcaktuara kushtetuese për kushtetutëbërje. Sa i përket asaj se sa respektohen rregullat ekzistuese mbi kushtetutëbërjen, dallohen dy trajta të realizimit të tyre: **kontinuiteti** dhe **diskontinuiteti**. Konsiderohet se ekziston **kontinuiteti kushtetues** atëherë kur kushtetutëbërësi zbaton rregullat ekzistuese kushtetuese mbi procedurën e bërjes së kushtetutës së re ose ndryshimin e kushtetutës ekzistuese. Nëse kushtetuta e re nuk është bërë sipas procedurës kushtetuese të përcaktuar me kushtetutën ekzistuese, atëherë flasim për **diskonitinuitet kushtetues**. Rregullat kushtetuese mbi rishikimin e kushtetutës nuk respektohen në rrethanat kur kushtetutëbërësi nuk dëshiron të ruaj lidhjen me regjimin dhe ideologjinë paraprake kushtetuese, siç janë, ta zëmë, ndryshimet revolutive dhe të thella të pushtetit (të dhunshme ose paqësore), puçet, grushtshtetet, okupimet dhe përmbysjet tjera ushtarake dhe kështu me radhë.

Kontinuiteti kushtetues mund të shoqërohet me kontinuitet përmbajtësor. Kushtetuta e re, e miratuar sipas rregullave ekzistuese mbi kushtetutëbërjen, zakonisht paraqet kontinuitet (vazhdimësi) të kushtetutës së re. E njëjta vlen edhe për diskontinuitetin kushtetues, që zakonisht paraqet ndërprerje përmbajtësore në mes dy kushtetutave. Kjo nënkupton se te diskontinuiteti futen parime dhe ideologji kushtetuese të reja, krijohet një organizim i ndryshëm i organeve politike të pushtetit. Kjo nuk vlen domosdo me organet apolitike, siç është rasti me organet gjyqësore, që mund të ngelin kryesisht në nivelin paraprak kushtetues dhe të ruajnë kontinuitetin e tyre në zhvillim.

6.1.3. Ndryshimi formal dhe faktik i kushtetutës

Mjaft i dobishëm është dallimi në mes të ndryshimit formal dhe faktit të kushtetutës, për shkak se bëhet fjalë për fenomene të ndryshme që hasen në konstitucionalizmin bashkëkohor. Te **ndryshimet formale të kushtetutës**, teksti i kushtetutës nuk ngelet e njëjtë, për arsye se ndryshon përmbajtja gjuhësore e normës kushtetuese ose tekstit ekzistues i shtohen norma të reja kushtetuese. Ndryshimi formal i kushtetutës mund të jetë e pjesshëm, kur ndryshojnë disa pjesë, nene apo dispozita të kushtetutës, dhe i plotë, kur miratohet kushtetuta e re. Organ i ndryshimit formal të kushtetutës është organi ligjvënës, parlamenti, i cili këtë e bënë sipas procedurës së posaçme. Te parlamentet dydhomësh kërkohet pëlqimi i dy dhomave (ta zëmë, rasti Gjermanisë së sotme). Dhomat sipas rregullit mblidhen ndaras, por mund të mblidhen edhe bashkërisht (ta zëmë, rasti francez sipas Kushtetutës së vitit 1875, në fakt sipas ligjeve kushtetuese të këtij viti).

Tradicionalisht, **kuvendi kushtetues** apo **konstituanta** (fr.: "assemblée constituante" ose vetëm"constituante") është krijuar dhe thirrur vetëm për të miratuar kushtetutën, pastaj është shpërbërë (Franca, Gjermania e Vajmarit, India pas pavarësimit, Indonezia pas pavarësimit, Italia pas Luftës së Dytë Botërore, SHBA, ish-Jugosllavia mbretërore pas Luftës së Parë Botërore etj.). Pra bëhet fjalë për situatat kur ka ndërprerje në zhvillimin e deriatëhershëm kushtetues, pra kur ka diskontinuitet, si pasojë e ndryshimeve radikale në statusin politik të entitetit që miraton kushtetutën e parë. Kjo nuk do të thotë se kushtetutat ekzistuese nuk përmbajnë dispozita mbi **asambletë kushtetuese**, duke sanksionuar në këtë mënyrë ushtrimin e pushtetit konstituiv origjiner brenda kornizës së përcaktuar kushtetuese. I tillë është rasti me **Bolivinë**,[288] **Ekuadorin**,[289] **Islandën**,[290] **Venezuelën**[291] etj). Kjo nuk ndryshon asgjë në konstatimin tonë fillestar, si më sipër,

[288] Neni 411 ["Supremacia dhe reforma e Kushtetutës"] i Kushtetutës. **Bolivia (Plurinational State of)'s Constitution of 2009**. Në internet: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/viewer.html?pdfurl= https%3A%2F%2Fwww.constituteproject.org%2Fconstitution%2FBolivia_2009.pdf (shikuar në mars 2022).

[289] Nenet 441-444 ["Amendamentimi Kushtetutës"] i Kushtetutës. **Constitution of the Republic of Ecuador** (2011). Në internet: https://pdba.georgetown.edu/Constitutions/Ecuador/english08.html (shikuar në mars 2022).

[290] Neni 79 (Kushtetuta nuk ka tituj e nëntiujt por vetëm nene pa asnjë mbishkrim) i Ksuhtetutës. **Iceland's Constitution of 1944 with Amendments through 2013**. Në internet: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/viewer.html?pdfurl=https%3A%2F%2Fwww.constituteproject.org%2Fconstitution%2FIceland_2013.pdf%3Flang%3Den (shikuar në mars 2022).

[291] Neni 347-349 ["Asambleja Kushtetuese Nacionale"] i Kushtetutës. **Venezuela (Bolivarian Republic of)'s Constitution of**

sipas të cilit pushtetit konstituiv i takon popullit sovran, i cili asnjëherë nuk mund të kufizohet juridikisht sepse prezumohet se ka liri politike për të vendosur çdo herë mbi fatin e tij politik, mbi mënyrën dhe formën e ekzistencës së tij politike. Kornizimi juridik i pushtetit origjiner, përmes rregullimit të mënyrës së formimit dhe juridiksionin (kompetencën) e asamblesë kushtetuese, përfaqëson njërën prej mënyrave të realizimit dhe ushtrimit të pushtetit konstituiv, efekt refleksiv dhe manifestim i të cilit është vetë ky kornizim. Kjo nënkupton se populli sovran mundet brenda kornizës së tillë juridike të thirrjes dhe funskionalizimit të asamblesë kushtetuese, por edhe jashtë saj dhe në kundërshtime, të shpreh vullnetin e tij sovran lidhur me formën dhe përmbajtjen e ekzistencës së vet politike.

Dy përbërje të parlamentit vendosin për ndryshime kushtetuese apo miratim të kushtetutës së re kur përbërja e parë merr vendim për nisjen e procedurës për një gjë të tillë dhe më pastaj shpërbëhet, kurse përbërja e re miraton ndryshimet e propozuara apo kushtetutën e re. Kjo procedurë në literaturë cilësohet si "referendum i fshehur", sepse për ndryshime kushtetuese apo për kushtetutë të re vendosin praktikisht qytetarët përmes zgjedhjes së përbërjes së re të parlamentit, që shpreh vullnetin e tyre. Të tilla janë zgjidhjet kushtetuese, ta zëmë, në **Belgjikë**,[292] **Danimarkë**,[293] **Spanjë**,[294] deri diku në **Zvicër**[295] etj. Dy debate mbi ndryshimet kushtetuese apo kushtetutën e re mund të zhvillohen edhe në përbërjen e njëjtë të parlamentit, në dy seanca të njëpasnjëshme, siç është rasti i **Italisë**.[296] Në procedurën e kushtetutëbërjes mund të marrin pjesë edhe trupat përfaqësuese të njësive federale, kryesisht në formë të verifikimit (ratifikimit) të ndryshimeve kushtetuese apo të kushtetutës së re, siç është rasti me **SHBA** (tri të katërtat e parlamenteve të shteteve anëtare),[297] **Zvicrën** (të gjitha kantonet zvicerane)[298] etj.

Qytetarët përmes **referendumit** marrin pjesë në procedurën e kushtetutëbërjes. Vendimi i qytetarëve në referendumin kushtetëbërës është i detyrueshëm. Ky lloj referendumi, ndërkaq, mund të jetë i detyrueshëm (si p.sh. **Danimarka**)[299] ose fakultativ me shumë mënyra për miratim të kushtetutës (si p.sh. **Franca**,[300] **Zvicra**[301]). Në **monarkitë parlamentare**, në procedurën e kushtetutëbërjes merr pjesë edhe kurora, e cila sjellë aktin mbi shpalljen e kushtetutës (**Danimarka**,[302] **Belgjika**,[303] **Holanda**[304] etj.). Kurora në këto vende është e zhveshur nga pushteti i vërtetë dhe vendimmarrja e saj ka natyrë deklarative.

Sa i përket **subjekteve që nisin procedurën e kushtetutëbërjes**, ata janë të caktuar me kushtetutë dhe mund të jenë: parlamenti, dhoma e parlamentit, anëtarët e parlamentit, shefi i shtetit, ekzekutivi,

---

1999 with Amendments through 2009. Në internet: chrome-extension://efaidnbmnnnib pcajpcglclefindmkaj/viewer.html?pdfurl=https%3A%2F%2Fwww.constituteproject.org%2Fconstitution%2FVenezuela_2009.pdf%3Flang%3Den (shikuar në mars 2022).

292 Neni 195 ["Mbi Rishikimin e Kushtetutës"] i Kushtetutës (1831). **The Belgian Constitution** (English translation) March 2021. Në internet: https://www.dekamer.be/kvvcr/pdf_sections/publications/constitution/GrondwetUK.pdf (shikuar në mars 2022).

293 Neni 88, Pjesa X (vetëm pjesa e fundit që flet për trashëgimin e fronit ka titull; asnjë pjesë tjetër e Kushtetutës nuk ka një të tillë) i Kushtetutës. **Denmark's Constitution of 1953.**

294 Nenet 166-169, Pjesa X ["Amendamentimi i Kushtetutës"] i Kushtetutës. **Spain's Constitution of 1978 with Amendments through 2011**.

295 Nenet 192-195, Titulli 6, Kapitulli 1 ["Rishikimi I Kushtetutës"] i Kushtetutës. **Federal Constitution of the Swiss Confederation of 18 April 1999** (Status as of 7 March 2021).

296 Nenent 138-139 ["Amendamentimi Kushtetutës. Ligjet Kushtetuese"] të Kushtetutës. **Constitution of the Italian Republic**.

297 Neni V i Kushtetutës. **Constitution of the United States**. Në internet: https://www.senate.gov/ civics/constitution _item/constitution.htm (shikuar në prill 2022).

298 Neni 140 (a) ["Referendumi i Detyrueshëm"] i Kushtetutës. **Federal Constitution of the Swiss Confederation of 18 April 1999** (Status as of 7 March 2021).

299 Si në fusnotën 293, **supra**, në këtë pjesë.

300 Neni 89 [:Mbi Amendamentimin e Kushtetutës"] i Kushtetutës (1958). **Constitution of France.**

301 Neni 140 (b) ["Referendumi i Detyrueshëm"] i Kushtetutës. **Federal Constitution of the Swiss Confederation of 18 April 1999** (Status as of 7 March 2021).

302 Si në fusnotën 293, **supra**, në këtë pjesë.

303 Si në fusnotën 293, **supra**, në këtë pjesë.

304 Neni 139 ["Rishikimi i Kushtetutës"] i Kushtetutës. **The Constitution of the Kingdom of the Netherlands 2018.** Në internet: https://www.government.nl/documents/reports/2019/02/28/the-constitution-of-the-kingdom-of-the-netherlands (shikuar në prill 2022).

një pjesë e trupës zgjedhore, njësia federale. Deputetët dhe votuesit duhet të jenë të përfaqësuar në një numër ose përqindje të caktuar, sepse së bashku mund të nisin procedurën e kushtetutëbërjes, siç është rasti, ta zëmë, me **SHBA** (dy të tretat e anëtarëve të Kongresit).[305] Pas nisjes së procedurës, në fazën e shqyrtimit nevojitet sigurimi i shumicës së kualifikuar, përkatësisht pjesëmarrja më e lartë e deputetëve nga ajo që kërkohet për shqyrtim të propozimeve legjislative, ta zëmë, një shumicë absolute (shumicën e numrit të përgjithshëm të përfaqësuesve në parlament). Në fazën e vendosjes kërkohet një shumicë edhe më rigoroze dhe atë si vijon: një shumicë absolute (në dy dhoma në **Itali**),[306] dy të tretat në dy dhoma (**Gjermania**),[307] tri të katërtat e numrit të shteteve (në **SHBA**),[308] tri të pestat (nga numri i votuesve, në **Francë**),[309] katër të pestat e deputetëve (në **Portugali**)[310] etj. Në këtë fazë të kushtetutëbërjes mund të marrin pjesë edhe votuesit, qoftë duke vërtetuar vendimin e marrë në parlament apo duke vendosur vetë mbi propozimin e ndryshimit apo kushtetutës së re. Në dy raste, zgjedhësit marrin vendimin meritor. Kushtet për vlefshmërinë e vendimit të referendumit janë të ndryshme: më së shpeshti kërkohet dalja e shumicës së votuesve kurse ka raste, si në **Danimarkë**, kur kërkohet shumica e më së paku dyzetë përqind të votuesve të regjistruar.

Më rastin e ndryshimit formal të kushtetutës, ose miratimit të kushtetutë së re, si dhe para nisjes së këtyre proceseve, një rol të rëndësishëm e luan opinioni publik dhe pjesëmarrja e tij. Kjo pjesëmarrje është e rëndësishme sepse nuk përfundon me vendim por me ndikim të opinionit në vendimmarrjen përfundimtare. Në vendet demokratike opinioni publik është i domosdoshëm dhe masovik në pjesëmarrje. Pjesëmarrja e opinionin publik konsiston në disa aktivitete: përpilimit të draftit të kushtetutës ose pjesëve të saj, organizimi i shqyrtimeve publike (tubimet profesionale, seminaret, konferencat shkencore, kritikës përmes medies etj.). Pjesëmarrës në këto shqyrtime publike janë nga shtresat dhe profesionet e ndryshme në shoqëri.

Ndalimi i ndryshimit të kushtetutës çdo herë ka të bëjë me ndryshimin formal, qoftë kur ndalimi është i përhershëm (klauzolat e përjetësisë), i kufizuar në kohë për një periudhë të caktuar, apo kur ka të bëjë me rrethanat e krizës (gjendja e luftës dhe e jashtëzakonshme).

Te **ndryshimet faktike të kushtetutës**, teksti i kushtetutës ngelet i njëjtë, mirëpo norma kushtetuese në praktikë fiton një kuptim tjetër. Ky ndryshim kushtetues, në thelb përbënë krijim të zakonit kushtetues, me të cilin interpretohet ose plotësohet kushtetuta ekzistuese formale. Teksti i kushtetutës së ndryshuar në aspektin faktik ngelet i njëjtë dhe i pandryshuar, deri në ndryshimin formal të saj.

Ndryshimi faktik i kushtetutës mund të ndodhë si pasojë e interpretimeve gjyqësore, në veçanti si pasojë e interpretimeve në gjyqësinë kushtetuese. Me interpretimin e normës kushtetuese që duhet të zbatohet në rastin konkret të vlerësimit të kushtetutshmërisë së një ligji, ta zëmë, gjykata kushtetuese mund të krijoj një kuptim tjetër të normës, e cila ngelet e njëjtë tekstualisht. Kjo formë e ndryshimit faktik të kushtetutës është veçanërisht e shprehur në përvojën amerikane, ku **GJSAm** bënë interpretimit jashtëzakonisht ekstensiv të **Kushtetutës së SHBA**. Në **Evropë**, me themelimin e gjykatave kushtetuese pas **Luftës së Dytë Botërore**, në veçanti në **Gjermani** dhe **Itali**, hasim në interpretime shumë të gjëra të normës kushtetuese, gjithnjë në funksion të pastrimit të rendit të vjetër juridik nga mbeturinat juridike të kohës së nazi-fashizmit. Më pas, ky standard shtrihet edhe në vendet tjera të botës demokratike, përfshirë këtu vendet ish-komuniste dhe **Kosovën**. Për këto çështje diskutojmë më gjerësisht në pjesën kur flasim për gjyqësinë kushtetuese. Si rast tjetër është kur gjyqësori kushtetues nuk shpall jokushtetues ligjin që është qartazi jokushtetues. Ligji i tillë ngelet në sistemin juridik, prodhon efekte dhe faktikisht ndryshon kushtetutën ekzistuese formale.

---

305 Si në fusnotën 297, **supra**, në këtë pjesë.

306 Si në fusnotën 300, **supra**, në këtë pjesë.

307 Neni 79.2 [“Amendamentimet ne Ligjin Themelor”] i **LTH**. **Basic Law for the Federal Republic of Germany. 1949, as amended to 2019**.

308 Si në fusnotën 297, **supra**, në këtë pjesë.

309 Si në fusnotën 300, **supra**, në këtë pjesë.

310 Neni 284.2 [“Përgjegjësia dhe Koha e Rishikimit”] i Kushtetutës. **Portugal’s Constitution of 1976 with Amendments through 2005**.

6.2. Miratimi dhe ndryshimi i kushtetutës së Kosovës dhe i vendeve përreth saj

Siç e treguam më herët, **Kushtetuta e Republikës së Kosovës** është miratuar nga një kuvend i zakonshëm, që në të njëjtën kohë ka luajtur edhe rolin e një kuvendi kushtetues. Kjo ka ndodhur më datën 9 prill 2008. Në fuqi ka hyrë më datën 15 qershor të po atij viti. Nxjerrja e saj ka qenë pjesë e zotimit ndërkombëtar të njëanshëm të Kosovës, me efekt **erga omnes**, i marrë përsipër përmes **Deklaratës së Pavarësisë** më datë 17 shkurt 2008, me të cilin vendi është shpallur shtet sovran dhe i pavarur.[311] Në kuptim të së drejtës kushtetuese pozitive, ndërkaq, **Deklarata e Pavarësisë** paraqet normën e parë kushtetuese të Kosovës, "grundnorm"-ën e saj, përkatësisht "Kushtetutën e parë historikisht shikuar" (Hans Kelsen)[312] apo "vendimin total lidhur me natyrën dhe formën e unitetit politik" (Karl Shmit).[313] Bazuar në këtë normë të parë dhe me qëllim të vënies në jetë të zotimit (premtimit) ndërkombëtar të marrë publikisht kundrejt të gjithëve, Kosova nxorri Kushtetutën e vet me të cilën instaloi jo një demokraci të shumicës, por një demokraci që nuk është as e pakicës dhe as e shumicës. Procedura për hartimin e Kushtetutës, ndërkaq, ishte ajo e skicuar në **Planin Ahtisari**, i cili u bë pjesë e së drejtës pozitive kosovare pikërisht përmes Deklaratës së Pavarësisë.[314]

---

311 Në grupin e akteve të njënashme juridike të cilat prodhojnë efekte juridike dhe detyrime në të drejtën ndërkombëtare, njejtë si marrëveshjet ndërkombëtare, hyn në kohën më të re edhe zotimi (premtimi). Ky është një akt i njënashëm i dhënë në mënyrë publike nga ana e shtetit me të cilin shprehet vullneti shtetëror për vënien në jetë të asaj që premtohet me tekstin e zotimit (premtimit). Krahas tij, në literaturë zakonisht numërohen këto akte të njëanshme juridike si burime të së drejtës: notifikimi (lajmërimi), njohja (pranimi), protesta dhe heqja dorë. Këto nganjëherë grupohen në dy grupe, sipas fuqisë së tyre si burime të së drejtës ndërkombëtare. Në grupin e parë hyjnë ato akte të njëanshme me të cilat premtohet diçka, kurse në të dytin hyjnë ato akte juridike të njëanshmme me të cilat hiqet dorë nga një e drejtë subjektive që një shtet e ka.Kur zotimi (premtimi) bëhet kundrejt tërë bashkësisë ndërkombëtare, siç ka qenë, ta zëmë, rasti i Francës për moskryerjen e testimeve nukleare në **Pacifikun e Jugut** (1974), atëherë të gjitha shtetet kanë të drejtë që të thirren në të për të realizuar një të drejtë apo për të imponuar një detyrim ashtu siç janë premtuar ato në publik. E kësaj natyre është, pa asnjë dyshim, edhe **Deklarata e Pavarësisë**: paragrafi i saj i fundit, pa dykuptimësi, përmban zotimin (premtimin) e njëanshëm të Kosovës me përmbajtjen si vijon: "[…]. Ne, nëpërmjet kësaj, afirmojmë në mënyrë të qartë, specifike dhe të parevokueshme se Kosova do të jetë ligjërisht e obliguar të plotësojë dispozitatat e përmbajtura në këtë Deklaratë, përfshirë këtu veçanërisht obligimet e saj nga Plani i Ahtisaarit. Në të gjitha këto çështje, ne do të veprojmë në pajtueshmëri në parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, përfshirë Rezolutën 1244 (1999). Ne shpallim publikisht se të gjitha shtetet kanë të drejtën të mbështeten në këtë Deklaratë, dhe i bëjmë apel të na ofrojnë përkrahjen dhe mbështetjen e tyre". Mbi natyrën juridike të **Deklaratës së Pavarësisë** si një akt i njëanshëm në të drejtën ndërkombëtare, cf. më shumë në Colin Warbrick, "Kosovo: The Declaration of Independence". *International and Comparative Law Quarterly.* Vol. 57 No. 03 (2008) fq. 675-690, në fq. 679 & 684; Marc Weller, *Shtetesia e kontestuar. Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*, fq. 377.
Sa i përket vlefshmërisë, për zotimin (premtimin) e dhënë në publik vlejnë të njejtat kushte që vlejnë edhe për marrëveshjet ndërkombëtare: ai nuk duhet të jetë në kundërshtim me normat **jus cogens** të së drejtës ndërkombëtare, nuk guxon të cenojë të drejtat e shteteve të treta, zbatimi i tij duhet të jetë i mundshëm në aspektin material, realizimi i tij duhet të bëhet me mirëbësim (*bona fide*) dhe kështu me radhë. Për natyrën juridike si dhe për caqet e vlefshmërisë së akteve të njëanshme juridike në të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare, përfshirë zotimin (premtimin) e dhënë në publik, cf. më shumë në punimet si vijon: Alfred P. Rubin, "The International Legal Effects of Unilateral Declarations". *American Journal International Law* Vol. 71 No. 1 (1977) fq. 1-30; Jean Didier Sicault, "Du caractère obligatoire des engagements unilatéraux en droit international public". *Revue Général de Droit International Public* Vol. 83 (1979) fq. 633–688; Jean Charpentier, "Engagements unilatéraux et engagements conventionnels: Différences et convergences". Në Jerzy Makarczyk (ed.), *Theory of International Law at the Threshold of the 21st Century: Essays in Honour of Krzysztof Skubiszewski* (Kluwer Law International: The Hague, 1996), fq. 367–380; Karl Zemanek, "Unilateral Legal Acts Revisited", në Karel Wellens, ed., *International Law: Theory and Practice; Essays in Honour of Eric Suy*. (The Hague: Martinus Nijhoff, 1998), fq. 209–221; Eric Suy, "Unilateral Acts of States as a Source of International Law: Some New Thoughts and Frustrations". Në Olivier Corten, Pierre Klein, Anne Lagerwall, et al., *Droit du pouvoir, pouvoir du droit: Mélanges offerts à Jean Salmon* (Bruylant: Brussels, 2007) fq. 631-642; Vladimir Đuro Degan, *Međunarodno pravo* (Skolska Knjiga: Zagreb, 2011) fq. 192 – 194.

312 Cf. Hans Kelsen, *Pure Theory of Law* (The Lawbook Exchange, Ltd.: Clark, New Jersey, 2002, 2009) fq. 193-194; 198-205.

313 Cf. Carl Schmitt, *Constitutional Theory*, fq. 60-61, 67-68, 70 71, 74, 77-80, 82-84, 87-88, 102-103, 107-11, 125, 142, 148.

314 Në këtë kuptim, Deklarata është akti i parë i ushtrimit të pushtetit konstituiv origjiner të popullit të Kosovës, kurse Kushtetuta asgjë pos vënie në jetë e zotimit të marrë me Deklaratë, ku hyn edhe zotimi i Kosovës se do të

Me Kushtetutë u bë operacionalizimi i substancës së dispozitave të Planit, që përcaktonin Kosovën si një demokraci specifike kushtetuese, që bazohet në parimin e ndarjes dhe balancimit të pushtetit, sundimin e ligjit dhe respektin për të drejtat e njeriut dhe të komuniteteve, të cilat nuk kanë epërsi pushteti ndaj njëri tjetrit. Kjo lloj demokracie, ku të gjitha komunitetet janë njëkohësisht pakicë dhe shumicë, që shtrohet në tërë territorin e vendit dhe reflektohet në organizimin dhe funksionimin e secilit organ qendror dhe lokal të pushtetit, në teorinë dhe praktikën kushtetuese njihet si **demokraci konsociacionale**. Futja e këtij modeli të demokracisë në Kosovë ka qenë pasojë e drejtpërdrejtë e ndikimit të fuqishëm të faktorit ndërkombëtar në draftimin e Deklaratës dhe Kushtetutës.[315] Pjesëmarrja e vendeve të huaja dhe faktorit tjetër ndërkombëtar në ndërtimin dhe ushtrimin e vullnetit origjinal kushtetutëbërës, **pouvoir constituiant originaire**, jo domosdo është gjë e keqe: rastet e Gjermanisë dhe Japonisë pas Luftës së Dytë Botërore janë shembull tipik i anëve pozitive të situatave kur pushteti origjinal kushtetutëbërës ndahet me vendet e huaja dhe faktorët tjerë ndërkombëtarë.

Arsyet për instalim të **demokracisë konsociacionale** në **Kosovë** janë kryesisht të natyrës historike: me shumë të drejtë është vërejtur para shpalljes së pavarësisë se e kaluara tragjike në Kosovë, "ndarjet e thella dhe fragmentimet e brendshme nëpër nën-kultura armiqësore" [316] mund të adresohen vetëm përmes instalimit të demokracisë konsociacionale. Kjo demokraci, pra, është instaluar si një "përpjekje e vetëdijshme e elitës me qëllim të stabilizimit të sistemit".[317] Instalimi nga "lart-poshtë" i demokracisë konsociacionale me qëllim të stabilizimit të sistemit, në rastin kosovar përkthehet si një përpjekje e qëllimshme e elitës vendore, e bërë me synim konsolidimin e shtetësisë në planin ndërkombëtar dhe fitimin e sa më shumë njohjeve ndërkombëtare.[318] Ky model i demokracisë nënkupton futjen e garancioneve specifike kushtetuese për promovimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të komuniteteve etnike dhe të komuniteteve tjera kosovare: me këtë hap në pushtetndarjen e gjithanshme, **Kosova** ia ka bërë të qartë botës

respektoj **Planin Ahtisari**, përfshirë njohjen e epërsisë së tij sa i përket rregullimit të brendshëm kushtetues (një shoqëri multietnike me demokraci konsociacionale, e bazuar në parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe respektimit të sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve etnike, fetare, gjuhësore dhe të tjera) dhe detyrimeve ndërkombëtare të vendit. Këtu pra ka dy akte juridike: i pari akt juridik është Deklarata e Pavarësisë, që u prodhua nga ushtrimi i pushtetit konstituiv origjiner nga ana e kosovarëve dhe përfaqëson grundormën e vendit; i dyti akt juridik është akti juridik që doli nga realizimi i pushtetit kushtetutëbërës, duke u bazuar në aktin e parë juridik, Deklaratën e Pavarësisë, dhe përfaqësohet nga Kushtetuta e Kosovës. Si ushtrimi i pushtetit konstituiv origjiner, ashtu edhe realizimi i pushtetit kushtetutëbërës u bënë me mbështetjen dhe nën ndikimin e fuqishëm të faktorit ndërkombëtar. Ky ushtrim i pushtetit konstituiv dhe pasoja e tij, realizimi i pushtetit kushtetutëbërës, me të drejtë në literaturë janë cilësuar si **pushtet konstituiv** dhe **kushtetutëbërëje e internacionalizuar**. Cf. gjerësisht për këtë në Michael Riegner, "The Two Faces of the Internationalized *pouvoir constituant*: Independence and Constitution-Making Under External Influence in Kosovo". **Goettingen Journal of International Law** Vol. 2 No. 3 (2010), fq. 1035-1062 në fq. 1041-1049.

315 Në literaturë kjo është cilësuar edhe si një ndarje e pushtetit original kushtetutëbërës, **pouvoir constituant**, në mes të vendorëve dhe ndërkombëtarëve. Cf. më shumë për këtë në Cf. Emily Hay, "International (ized) Constitutions and Peacebuilding". *Leiden Journal of International Law* Vol. 27 No. 1 (2014) fq. 141-168 (autorja, duke analizuar nga aspekti komparativ rastet e Kosovës dhe të Irakut, vjen në përfundimin se kushtetutat e ndërkombëtarizuara gjatë historisë kanë potencial për të qenë legjitime dhe jolegjitime, në vartësi të rrethanave të secilit vend dhe kontekstit historik; ajo në mënyrë të shkëlqyer konstaton, duke sqaruar pse-në, se kushtetutat e ndërkombëtarizuara sfidojnë rëndë konceptet themelore tradicionale mbi sovranitetin, vetëvendosjen dhe Kushtetutën dhe rolin e funksionin e saj në një shoqëri të organizuar në shtet).

316 Arend Lijphart, "Consociational Democracy". *World Politics* Vol. 21 No. 2 (1969) fq. 207-225, në fq. 213, 215.

317 Arend Lijphart, "Constitutional Design for Divided Societies". *Journal of Democracy* Vol. 15 No. 2 (2004) fq. 96-109, në fq. 97.

318 Professor Louis Aucoin, "Views from the Field On Constitution Writing: The Case of Kosovo (Interview)". *PRAXIS: The Fletcher Journal of Human Security* XXIII (2008) fq. 123-128, në fq. 125; John Tunheim, "Rule of Law and the Kosovo Constitution". *Minnesota Journal of International Law* Vol. 18 No. 2 (2009) fq. 371-379, në fq. 375; Emily Hay, "International (ized) Constitutions and Peacebuilding", fq. 160-161; Silvia Suteu, *Eternity Clauses in Democratic Constitutionalism*, fq. 171-176 (autorja flet për pushtetin konstituiv të internacionalizuar, jo vetëm në kontekstin e Kosovës, por gjerësisht nëpër botë, duke konstatuar se në tri dekadat e fundit, akterët ndërkombëtar kanë qenë të involvuar, nëse jo drejtues të drejtpërdrejtë në ushtrimin e pushtetit kushtetutëbërës, në vendet si Bosnje-Hercegovina, Iraku, Kosova, Timori Lindor etj.).

se modeli konsociacional i ndarjes së pushtetit në planin horizontal dhe vertikal, si dhe njohja e vetos për komunitetet lidhur çështjet që prekin interesat e tyre vitale paraqet një projekt real dhe serioz në funksion të ndërtimit të shtetit kosovar sipas parimeve liberale të demokracive kushtetuese perëndimore.

Çdo ndryshim i **Kushtetutës së Kosovës** komandohet nga dispozitat e nenit të saj 144, që normon amendamentimin. Ky nen duhet të lexohet në dritën e doktrinës mbi amendamnetet jokushtetuese, përkatësisht së bashku me **klauzolën kosovare të përjetësisë** që ankorohet në kapitullin e dytë të Kushtetutës, gjykuar sipas formulimit të paragrafit të tretë të nenit 144, i cili ndalon çdo ndryshim kushtetues që pakëson liritë dhe të drejtat nga kapitulli i dytë i saj.[319] Në interpretimet e Gjykatës Kushtetuese, Përveç këtij kapitulli është futur edhe kapitulli i tretë si parametër për vlerësim të kushtetutshmërisë së çdo ndryshimi kushtetues, si dhe shpirti i Kushtetutës, pa definuar se çfarë nënkuptohet me shpirt të saj. Këtu bëhet fjalë, në mënyrë të qartë, për ndryshim faktik të dispozitave kushtetuese nga neni 144.3 i Kushtetutës, duke futur edhe kapitullin e tretë si parametër vlerësimi, në një kohë që është e qartë se neni 144.3 bën fjalë vetëm për kapitullin e dytë si parametër për vlerësim kushtetues, duke mos përmendur fare shpirtin e vet si parametër vlerësimi të kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese. Sidoqoftë, kjo qasje e gjyqësisë kushtetuese është krejt e pranueshme marrë parasysh faktin se klauzolat e përjetësisë në kushtetutat e vendeve pas konfliktit shërbejnë për të rregulluar hierarkinë e normave kushtetuese dhe për të vënë rend në kaosin juridik që gjenden vendet e tilla.[320]

Dispozitat kushtetuese si më sipër duhen parë në dritën e mbrojtjes së **demokracisë konsociacionale**, e instaluar në Kosovë qysh pas mbarimit të luftës në qershor të vitit 1999, përmes rregullativës së administratës ndërkombëtare në Kosovë, përkatësisht **UNMIK**.[321] Nëse analizohen dispozitat e **Kushtetutës së Kosovës** mbi liritë e të drejtat e njeriut dhe të komuniteteve (kapitujt dy dhe tre), do të shihet qartë se ato nuk kanë ndonjë dallim thelbësor me dispozitat që ka instaluar **UNMIK** për lëmin e njëjtë: në dy rastet bëhet fjalë për futjen në mënyrë të sforcuar të disa garancive juridike në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve, me qëllim të promovimit dhe ruajtjes së **demokracisë konsociacionale**.

Kosova nuk është e vetme në këtë drejtim: aktualisht mund të vërehen tri kategori të dispozitave mbi **klauzolat e përjetësisë** në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut, që janë futur në kushtetuta të botës së qytetëruar me qëllim të mbrojtjes së demokracive vendore.[322] Në grupin e parë hyjnë zotimet për mosamendamentim të disa të drejtave të caktuara (diskrete). Si shembull tipik i këtij grupi shërben neni 79 i **LTH**, i cili i referohet neneve 1 dhe 20, si dispozita që rrënjosin të drejtat e caktuara dhe krejt specifike.[323] Në grupin e dytë hyjnë kushtetutat e vendeve që përmbajnë zotime për respektim të të drejtave të njeriut të përmbajtura në klauzolat e përjetësisë, siç është, ta zëmë, **Kushtetuta e Turqisë** (1982).[324]Ekzistojnë kushtetuta që mbërthejnë dy llojet e zotimeve si më sipër, siç është rasti, ta zëmë, me **Kushtetutën e Federatës Ruse** (1993).[325] Caqet e klauzolave të përjetësisë nga katego-

[319] Neni 144.3 i Kushtetutës së Kosovës përcakton si vijon: "Ndryshimet në këtë Kushtetutë mund të miratohen nga Kuvendi vetëm pasi të ketë adresuar Kryetari i Kuvendit të Kosovës amendamentin e propozuar në Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar paraprakisht nëse ndryshimi i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës".

[320] Silvia Suteu, *Eternity Clauses in Democratic Constitutionalism*, fq. 61.

[321] Cf. Seksioni 4.2, **supra**, në këtë pjesë, dhe komentet tona aty lidhur me këto rregullore.

[322] Silvia Suteu, *Eternity Clauses in Democratic Constitutionalism*, fq. 40-45.

[323] Cf. fusnotat 217, 218, 221, **supra**, në këtë pjesë, dhe komentet tona atje.

[324] Sipas dispozitës së nenit 4 ["Dispozitat e Pandryshueshme"] të Kushtetutës, në këto ndalesa hyjnë: forma republikane e Shtetit turk, karakteri demokratik, laik, sekular i udhëhequr nga sundimi i ligjit, demokracia, drejtësia sociale, të drejtat e njeriut, lojaliteti ndaj nacionalizmit të Ataturkut, cilësitë themelore të Preambulës, territori i pacenueshëm dhe unitetit i shtetit dhe kombit, gjuha turke, flamura, stema dhe himni nacional turk. **Turkey's Constitution of 1982 with Amendments through 2017.** Në internet: https://www.constituteproject.org › (shikuar në mars 2022).

[325] Neni 135.1 ["Amendamentimi dhe Rishikimi Kushtetutës"] i Kushtetutës thekson se dispozitat e kapitujve 1, 2 dhe 9 nuk mund të rishikohen. Këta kapituj kanë të bëjnë me bazat e sistemit kushtetuese (kap.1), liritë dhe të drejtat e njeriut (kap. 2) dhe

ria e dytë, megjithatë, nuk janë të qarta. Ato bëhen të qarta vetëm përmes interpretimit gjyqësor. Në kategorinë e tretë, që është më e përhapura, hyjnë dispozitat kushtetuese që përjetësojnë një standard minimal të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, duke i larguar ato dispozita përgjithmonë nga procesi amendamentues. Kjo nuk do të thotë se krahas këtyre përjashtimeve nga amendamentimi që kanë të bëjnë me lirinë dhe të drejtat e njeriut, përjashtohen klauzolat që kanë të bëjnë me formën dhe karakterin e shtetit dhe vlerat tjera kushtetuese dhe nacionale. Këtu hyjnë vendet si, ta zëmë, **Rumania**,[326] **Bosnje-Herceovina**[327] dhe **Kosova**,[328] të cilat i referohen standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, si një parametër për vlerësim të caqeve të klauzolave të përjetësisë të sanksionuara me kushtetutat respektive. Në rastin kosovar, dispozitat e kapitullit të dytë, tridhjetë e pesë nenet e tij, **që formojnë esencën e klauzolës së përjetësisë në Kosov**ë, së bashku me dispozitat mbi shumicën prej dy të tretave dhe veton ndaj amendamenteve që posedojnë komunitetet etnike në pakicë, formojnë elementet e një strukture kushtetuese të ngurtë. Qëllim i kësaj ngurtësie, e cila është përcaktuar nga bashkësia ndërkombëtare, është sigurimi i **demokracisë konsociacionale** pas konfliktit të përgjakshëm në Kosovë, të shkaktuar nga forcat serbe (1998-1999). Për më tepër, neni 113.4 i **Kushtetutës së Kosovës** ofron një siguri shtesë sepse autorizon Gjykatën Kushtetuese për vlerësim kushtetues të pajtueshmërisë së amendamenteve të propozuara kushtetuese me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare. Ky autorizim shtrihet në rend të parë ndaj tetë marrëveshjeve të instrumenteve ndërkombëtare të numëruara në nenin 22 të Kushtetutës dhe ngërthen detyrimin e interpretimit të garancive mbi të drejtat e njeriut në pajtim më vendimet e **GJEDNJ-së** (neni 53 i Kushtetutës së Kosovës).[329]

Në Shqipëri, çështja e **grundnormës** duket më e komplikuar se në rastin e **Kosovës**, për shkak se ushtrimi për herë të parë i **pushtetit konstituiv origjiner** që ka prodhuar aktin e parë juridik, shpalljen e pavarësisë së Shtetit shqiptar, i takon historisë së largët. Nga ajo kohë deri më sot ka pasur ushtrime të pushtetit konstituiv disa herë të tjera, që nuk kanë rezultuar në krijimin e shtetit të ri në kuptim të subjektit të së drejtës ndërkombëtare: formën dhe përmbajtjen e ekzistencës politike, Shqipëria e ka definuar më 28 nëntor 1912, si shtet sovran dhe i pavarur. Si pikë referimi për këto ushtrime të pushtetit konstituiv, qoftë derivativ apo tërësisht në rrethana revolutive (siç kanë qenë kushtetutat komuniste që bënë ndërprerjen totale me rendin e mëparshëm kushtetues), në kontekstin shqiptar merren asambletë konstituive dhe organizimet tjera që janë formuar për të marrë vendim mbi karakterin e shtetit dhe formën e pushtetit shtetëror. Këto i trajtuam gjerësisht më sipër në seksionin mbi **zhvillimin e konstitucionalizmit shqiptar**.[330]

Aktualisht në fuqi, **KShq**, është miratuar më 1998.[331] Me të Shqipëria ka ndryshuar vetëm formën dhe karakterin e shtetit dhe pushtetit, duke krijuar një shtet që bazohet në parimin e sundimit të ligjit, pluralizmin politik dhe pronësor, respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, gjyqësorin e pavarur, përfshirë këtu një gjyqësi kushtetuese si gardian i garancive kushtetuese. Kushtetuta ka **dispozita mbi amendamentimin**, që gjenden në nenin 177 të pjesës së saj të shtatëmbëdhjetë. Nisma për amendamentim merren me një shumicë të një të pestës së deputetëve të **Kuvendit të Shqipërisë**, kurse miratimi i tyre bëhet me shumicën prej dy të tretave. Amendamentimi mund të bëhet edhe përmes referendumit, kur këtë e kërkojnë dy të tretat e deputetëve (referendumi fakultativ) ose kur një gjë e tillë e kërkon një e pesta e tyre (referendumi i detyrueshëm). Akti juridik me të cilin shprehet amendamentimi ka formën e **projektligjit për rishikim të Kushtetutës**.

vetë procedurën e amendamentimit dhe rishikimit (kap. 9). **Russian Federation's Constitution of 1993 with Amendments through 2008**. Në internet: https://www.constituteproject.org/constitution /Russia_2014?lang=en (shikuar në prill 2022).

326 Neni 152 paragrafët 1 dhe 2 ["Kufijt e Amendamentimit Kushtetues"] i Kushtetutës së Rumanisë (1991). **Romania's Constitution of 1991 with Amendments through 2003**. Në internet: https://www.constituteproject.org/constitution/Romania_2003.pdf?lang=en (shikuar në prill 2022).

327 Neni X (2) ["Amendamentimi"] i Kushtetutës. **Bosnia and Herzegovina's Constitution of 1995 with Amendments through 2009.** https://www.constituteproject.org/constitution/Bosnia_Herzegovina_2009.pdf?lang=en (shikuar në mars 2022).

328 Neni Article 144 (3) ["Amendamentimi"] i Kushtetutës.

329 Silvia Suteu, *Eternity Clauses in Democratic Constitutionalism*, fq. 65-66.

330 Cf. Seksioni 4.2, **supra**, në këtë pjesë, si dhe teksti që e shoqëron.

331 Cf. fusnotat 330, **supra**, dhe komentet tona aty.

Sa i përket **Maqedonisë së Veriut**, më herët folëm **grundnormën** dhe **KMver**, përfshirë arsyet për amendamentim e saj deri më sot.[332] Nenet 129-131 të **KMVer** normojnë procedurën për amendamentim, i cili ndodh nëse për të votojnë dy të tretat e krejt deputetëve të Kuvendit të Maqedonisë së Veriut. Një shumicë e njëjtë e kualifikuar kërkohet edhe për nisjen e procedurës për amendamentim.

Mali i Zi, për dallim nga Maqedonia e Veriut, një kohë të caktuar ka qenë në një union shtetëror me Serbinë, fillimisht si federatë (pas pranverës së vitit 1992 e deri në Marrëveshjen e Beogradit të vitit 2003) e më pas si union shtetëror Serbi-Mali i Zi. Me këtë union, Mali i Zi akoma ka pasur subjektivitet të plotë ndërkombëtar, që posedohej nga Unioni si tërësi. Më 21 maj 2006, sikundër u sqarua më sipër,[333] **Mali i Zi** ndërtoj **grundnormën** e vet të parë, kur me referendum u deklarua për pavarësim e sovranitet të plotë nga Serbia.[334] Vullneti i këtij referendumi u ratifikua nga **Kuvendi i Malit të Zi** më 3 qershor 2006. Pas kësaj, pasoj nxjerrja e **KMZi**, një dokument krejt i ri dhe i ndryshëm nga dokumenti pararendës me të cilin ishte qeverisur vendi deri atëherë. KMZi nuk përmban **klauzola të përjetësisë**, por disa pengesa procedurale për amendamentim. Sa i përket dispozitave substanciale, nenin e saj 157, siç e kemi sqaruar te pjesë mbi burimet, **supra** 5.3., KMZi tregon se ato mund të amendamentohen vetëm nëse për to votojnë tri të pestat e krejt votuesve në **Mal të Zi**. Ndryshimi i KMZi, ndërkaq, mund të bëhet me dy të tretat e krejt anëtarëve të Kuvendit të Malit të Zi. Ky ndryshim nënkupton amendamentimin e pjesëve të caktuara apo nxjerrjen e një kushtetutë të re, thuhet në nenin 155.2 të KMZi.

Fqinji ynë verior, **Serbia**, ka një kushtetutë shumë të çuditshme, për dallim nga vendet tjera fqinje. As në këtë vend nuk ekziston klauzola e përjetësisë. Për disa situata, siç e kemi shpjeguar në pjesën 5.3, **supra**, që bënë fjalë për burimet, për amendamentim të **KSerb** nuk mjafton vota e dy të tretave të krejt deputetëve të **Kuvendit të Serbisë**, siç kërkohet të paragrafin e dytë të nenit 2003 të Kushtetutës, por duhet patjetër të vërtetohet (ratifikohet) përmes një referendumi. Këto ndryshime për të cilat kërkohet referendumi kanë të bëjnë me çështjet siç janë: preambulën, parimet kushtetuese, të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, rregullimi i pushtetit, shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme dhe gjendjes së luftës, shmangia nga liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve gjatë gjendjes së luftë dhe gjendjes së jashtëzakonshme, dhe procedurën e ndryshimit të **KSerb.** Sikundër dihet, në preambulën e **KSerb** gjendet edhe zotimi serb për tërësinë territoriale të Serbisë, me Kosovën brenda (të cilën e quajnë me emrin mesjetar kishtar ”Kosova dhe Metohija”).

Vendimi mbi shpalljen e pavarësisë së **Malit të Zi** (3 qershor 2006) ka pasur karakter konstituiv, sepse ka qenë pjesë e hapave që duheshin ndërmarrë sipas bazës juridiko-kushtetuese të bashkësisë së përbashkët shtetërore me Serbinë. Me të Kuvendi i Malit të Zi ka shprehur vullnetin e vet për vënien në jetë të rezultateve të **referendumit** të datës 21 maj të atij viti. Sipas të drejtës ndërkombëtare, megjithatë, as **Mali i Zi** e as **Serbia** pas 21 majit 2006 (kur u pavarësua Mali i Zi) nuk janë rikrijuar mbi bazat e shtetësisë së vjetër që kanë pasur para 1 dhjetorit 1918, por si shtete tërësisht të reja të dala nga rrënojat e ish-Jugosllavisë. Dy këto shtete, pra, nuk kanë qenë kontinuitet i ish-Jugosllavisë dhe as i mbretërive malazeze dhe serbe që kanë ekzistuar para 1 dhjetorit 1918. Thënë më fjalë të tjera, **grundnorma** e Malit të Zi sot nuk qëndron në shek. XIX, në vitin 1852, por ankorohet në aspektin kohor në datën 21 maj 2006, ditë kur u pavarësua Mali i Zi dhe, për pasojë, edhe Serbia me automatizëm u shndërrua në shtet sovran dhe të pavarur, me subjektivitet të plotë ndërkombëtar. Kështu, u mor vesh, nuk mendojnë konstitucionalistët serbë. Këtë e kemi sqaruar gjerësisht në seksionin 4.2, **supra**, kur kemi folur për zhvillimin e konstitucionalizmit në Kosovë, botën shqiptare dhe vendet përreth.

---

332 Cf. Seksioni 4.2. dhe 5.3.3., **supra**, si dhe komentet tona aty.

333 Cf. Seksioni 4.2. dhe 5.3.4., **supra**, si dhe komentet tona aty.

334 Me sa duket, për shkak të përvojës së hidhur të aleancave dhe lidhjeve shtetërore me Serbinë në të kaluarën, **KMZi** në paragrafin e fundit të nenit 15 [“Marrëdhëniet me shtetet tjera dhe organizatat ndërkombëtare“] përmban një dispozitë jo fort të zakonshme, që thotë se “Mali i Zi nuk mund të hyj në aleancë me asnjë shtet që rezulton në humbje të pavarësisë dhe subjektivitetit të plotë ndërkombëtar”.

7. Ndarjet e kushtetutave

Ekzistojnë disa kritere mbi bazën e të cilave bëhet ndarja dhe klasifikimi i kushtetutave. Ato kritere kanë të bëjnë me cilësitë politike të kushtetutave, mënyrën e zbatimit të tyre, rrethanat shoqërore nën të cilat kanë lindur, formën e qeverisjes që kultivojnë, organizimin e pushtetit që sanksionojnë, formën e kushtetutës së shkruar, organin dhe procedurën për miratim të kushtetutës. Klasifikimet e kushtetutave i ndihmojnë kuptimit më të mirë të natyrës së kushtetutës dhe nevojës teorike dhe praktike për gjetjen e dizajnit kushtetues më të mirë të mundshëm. Përveç kësaj, ndarjet e kushtetutave ndihmojnë për të gjetur përgjigjen në pyetjen se çka është në të vërtetë kushtetuta dhe sa dallon nga aktet tjera politike dhe juridike. Pikërisht për këtë arsye, me këtë temë në periudha të ndryshme përgjatë historisë janë marrë juristë të njohur, filozofë e sociologë, siç janë: **Xhejms Brys** (James Bryce: 1838-1902), që ka bërë ndarjen klasike të kushtetutave, **Albert V. Dajsi** (Albert Venn Dicey: 1835-1922), pastaj, **Karl Lovenshtajn** (Karl Loewenstein: 1892-1973), **Keneth C. Uhare** (Sir Sir Kenneth Clinton Wheare: 1907-1979), **Karl Joakim Fridrih** (**Carl Joachim Friedrich: 1901-1984**) dhe shumë të tjerë.[335]

Sipas **cilësive politike**, kushtetutat ndahen në **kushtetuta demokratike** dhe **kushtetuta jodemokratike**. Të parat krijohen në mënyrë demokratike, nga ana e qytetarëve dhe e përfaqësuesve popullor. Kjo, megjithatë, nuk është krejt tregimi për këtë lloj të kushtetutave sepse kriteri më i rëndësishëm dhe përcaktues për këtë lloj kushtetute është brendia e tyre. Kushtetutat demokratike kufizojnë pushtetin dhe garantojnë liritë dhe të drejtat themelore, mbi themelet e tyre ngritët rendi demokratik. Të dytat lloje të kushtetutave nuk kufizojnë pushtetin, ashtu që në shtet nuk ndërtojnë një regjim politik demokratik, për arsye se për një gjë të tillë nuk ekziston përcaktimi kushtetues. Kushtetutat jodemokratike nënkuptojnë ekzistencën e një pushteti të theksuar autoritar, që posedon mekanizma juridik dhe fuqi politike për të rrezikuar dhe kufizuar liritë dhe të drejtat e njeriut (regjimet autoritare). Konstitucionalizmi jodemokratik është i mundur si në format republikane ashtu edhe në ato monarkike të qeverisjes.

Sipas **cilësive të normave kushtetuese**, nëse mbizotërojnë normat ideologjike apo normat që shprehin realitetin shoqëror ashtu siç është, kushtetutat mund të ndahen në **kushtetuta programatike** dhe **kushtetuta reale**. Të parat kushtetuta janë plane ideologjike për të ardhmen, në to skicohet e ardhmja e shoqërisë nga këndvështrimi ideologjik i caktuar. Në normat e këtij lloji të kushtetutave projektohet shoqëria në të ardhmen që duhet të ndërtohet, siç është, ta zëmë, rasti i deetatizimit si qëllim, që dikur proklamohej përmes fitores së komunizmit dhe krijimit të shoqërisë pa klasa ku shteti bëhet i tepërt. Kësi lloj normash kushtetuese gjenden në mjaft kushtetuta dhe kanë një vend të spikatur, siç ka qenë rasti i vendeve ish-komuniste. Të llojit të dytë, ndërkaq, do të ishin kushtetutat që janë pasqyrë e rrethanave shoqërore në shtet në një moment të dhënë historike. Kushtetutat e tilla shkruhen sipas idesë dhe mbështetjes së personaliteteve historike të një kohe, siç ka qenë rasti me Kushtetutën e Francës së vitit 1958, që sot e kësaj dite cilësohet si **Kushtetuta e Degolit**, sipas gjeneralit francez **Sharl De Gol** (Charles de Gaulle: 1890-1970), që udhëhoqi rezistencën kundër **Hitlerit** dhe udhëheqin **Francën** në drejtim të njohjes së pavarësisë dhe sovranitetit të **Algjerisë** (1962). Vlen të theksohet gjithashtu se, sipas rregullit, kushtetutat ngërthejnë dy lloje të normave si më sipër, ideologjike dhe reale, përkatësisht norma që përmbajnë qëllimet që shteti dhe shoqëria duhet të përmbushin dhe norma që reflektojnë në mënyrë besnike realitetin.

Bazuar në rrethanat shoqërore dhe historike të kohës së krijimit të kushtetutave, ato ndahen në **kushtetuta origjinere** dhe **kushtetuta derivative**. Të llojit të parë janë kushtetutat që nuk kanë pasur asnjë shembull apo model pararendës kur janë krijuar, duke u shërbyer më pastaj si model apo shembull për vendet tjera. I tillë është, ta zëmë, rasti i **Kushtetutës së SHBA**, si kushtetuta e parë liberale që në mënyrë gjithëpërfshirëse ka kodifikuar materien kushtetuese, **Kushtetuta e Rusisë Sovjetike** (1918), e cila ka qenë kushtetuta e parë socialiste. Pjesa dërrmuese e kushtetutave të botës së sotme janë kushtetuta derivative, sepse

[335] Për shkrimin e këtij seksioni mbi ndarjet e kushtetutave, kryesisht jemi mbështetur në artikullin e shkëlqyer hulumtues dhe analitik të Dieter Grimm, "Types of Constitutions", fq. 98-132.

përfaqësojnë përmbledhje të teksteve me zgjidhje të ndryshme kushtetuese që veç ekzistojnë në vende të ndryshme.

Sipas kriterit të zbatueshmërisë së kushtetutave, përkatësisht bazuar në kriterin ontologjik (marrëdhënia e kushtetutave ndaj realitetit), ato ndahen në tri grupe: **kushtetuta normative**, **kushtetuta nominale** dhe, së fundi, **kushtetuta semantike**. Të llojit të parë janë kushtetutat e vlefshme, i përgjigjen realitetit dhe zbatohen, kurse të llojit të dytë janë ato që kanë vlefshmëri juridike, por nuk i përgjigjen realitetit shoqëror dhe nuk gjejnë zbatim në praktikë. Së fundi, të llojit të tretë, kushtetutat semantike, janë ato që realizohen në praktikë por e ruajnë (konservojnë) realitetin, duke mos lejuar as ndryshime në shoqëri e as ndryshim të vetëvetës.

Sipas formës së qeverisjes që instalojnë, kushtetutat i ndajmë në **kushtetuta monarkike** dhe **kushtetuta republikane**. Këtu bëhet fjalë për atë se si është organizuar institucioni i shefit të shtetit – në kushtetutat monarkike, ai/ajo është monark, kurse në kushtetutat republikane, ai/ajo është president republike (më rrallë organ kolegjial-kryesi).

Bazuar në kriterin e organizimit të pushtetit, kushtetutat janë: **kushtetuta presidenciale**, **kushtetuta parlamentare** dhe **kushtetuta kuvendore**. Në kushtetutat e llojit të parë, pushteti është i organizuar në parimet e ndarjes së pastër të pushtetit, ku ligjvënësi, ekzekutivi dhe gjyqësori janë të ndarë nga njëri-tjetri aq sa është e mundur. Në kushtetutat e llojit të dytë, pushteti gjithashtu është i organizuar në parimin e ndarjes së pushtetit, por jo aq rreptë sa në kushtetutat presidenciale: në mes të ligjvënies dhe ekzekutimit ekziston marrëdhënia e baraspeshës, bashkëpunimit, ndërvarshmërisë dhe kontrollit reciprok. Kushtetutat kuvendore janë më të rrallat dhe organizimi i pushtetit në to bazohet në parimin e unitetit të pushtetit. Kuvendi është një organ i spikatur në raport me pushtetin ekzekutiv. Ky i fundit i përgjigjet kuvendit dhe nuk ka asnjë mekanizëm për baraspeshim ndaj tij. Si një lloj i veçantë i kushtetutave mund të jetë ai i kushtetutave të sistemeve të përziera, që kombinojnë elementet e këtyre sistemeve të pushtetit si më sipër, më së shpeshti ato të sistemit presidencial dhe parlamentar.

Ndarja e parë klasike e kushtetutave sipas formës në të cilën shfaqen është ajo e **kushtetutave të shkruara** dhe **kushtetutave të pashkruara**. Ato që janë të shkruara i kanë normat në formë të shkruar, kurse ato që nuk janë të shkruara përbëhen nga zakonet, rregullave kushtetuese që kanë vlefshmëri juridike. Asnjë shtet në botë nuk ka vetëm kushtetutën e pashkruar, sepse aty ku vlejnë zakonet e pashkruara, paralele me to ekzistojnë edhe normat e shkruara kushtetuese.

Ndarja klasike e kushtetutave të shkruara është ajo që ndan ato në **kushtetuta të kodifikuara** dhe **kushtetuta të pakodifikuara**. Të parat përbëhen nga një akt i vetëm kushtetues, kurse të dytat nga disa akte kushtetuese. Arsyeja pse kushtetuta nuk është e kodifikuar në një vend ka të bëjë me traditën (ta zëmë, vendet si: Danimarka, Finlanda dhe Suedia). Aktet e vjetra kushtetuese, si p.sh.: Ligjet suedeze mbi trashëgiminë e kurorës nga viti 1810 janë mbajtur në fuqi si pjesë e kushtetutës së pakodifikuar për shkak se dëshirohet të ruhet lidhja e sotme me traditën kushtetuese të vendit. Ajo që ka rëndësi këtu është se krejt aktet që përbëjnë kushtetutën e pakodifikuar zbatohen. Përveç si më sipër, kushtetuta e pakodifikuar ekziston edhe atëherë kur ekzistojnë shumë akte më fuqi juridike-kushtetuese, krahas kushtetutës. I tillë është, ta zëmë, rasti i Finlandës, në të cilën ekzistojnë, krahas kushtetutës, një mori ligjesh që kanë fuqi të plotë kushtetuese, siç janë: ligjet mbi Parlamentin, përgjegjësinë e ministrave dhe Gjykatën e Lartë për **impeachment**. I ngjashëm me këtë është rasti i ku disa akte kanë cilësi kushtetuese sepse miratohen në procedurë të posaçme, Kështu, ta zëmë, Kushtetutën e Francës të vitit 1875 e kanë përbërë tri akte juridike që kanë pasur të bëjnë me: Senatin, organizimin e pushtetit dhe marrëdhëniet në mes të pushteteve. Edhe situata e kundërt është e mundur: kur ekzistojnë shumë akte juridike, por që nuk miratohen në procedurë të posaçme por në procedurë të zakonshme ligjore, mirëpo ekziston një konsensus i përgjithshëm se përfaqësojnë

kushtetutën e vendit. I tillë është rasti me **Izraelin**, **Suedinë** dhe **Zelandën e Re**, ku ligjet e caktuara (kryesisht mbi liritë dhe të drejtat e njeriut), kanë epërsi (supremaci) ndaj ligjeve dhe normave të tjera brenda sistemit juridik.

Sipas asaj kush e sjell apo kush krijon kushtetutën, ato ndahen në **kushtetuta të dhuruara**, **pakte kushtetuese** dhe **kushtetuta të popullit**. Të parat i sjell në mënyrë autonome sundimtari (kurora). Kjo nuk është kështu me paktet kushtetuese, të cilat i miratojnë me marrëveshje sundimtari (kurora) dhe trupi përfaqësues: parlamenti miraton kushtetutën, kurse sundimtari (kurora) vetëm e vërteton. Të tretat, kushtetutat popullore, i miraton trupa përfaqësuese popullore, **parlamenti** ose **kuvendi kushtetues**, në mënyrë të pavarur ose me zgjedhës që deklarohen përmes referendumit kushtetues.

Kushtetutat e dhuruara mund të thuhet se i takojnë historisë: e para e këtij lloji është **Karta Kushtetuese** e Francës e vitit 1814, si dhe disa të tjera pas saj. Futja e përfaqësimit parlamentar gjatë shekullit XIX nuk ka nënkuptuar edhe zhvendosje të sovranitetit nga monarku te populli. Plot kushtetuta, të njohura si **karta kushtetuese** dhe **statute**, u nxorën, mirëpo shpallja e tyre u bë me vullnetin e Zotit, vullnet që u transmetua te qytetarët dhe populli nga goja e mbretërve evropianë. Këto ishin **kushtetuta të dhuruara**, që vetëm modifikonin pushtetin ekzistues, pa pasur asnjë fuqi themeluese të pushtetit publik. Për këtë arsye cilësohen edhe si **kushtetuta modifikuese** dhe **kushtetuta jo të plota**. Këto kushtetuta, e thënë me fjalë të tjera, nuk kanë krijuar pushtet publik nga e para, por vetëm kanë modifikuar pushtetin ekzistues duke përcaktuar një formë të re të strukturës shtetërore, organe e kompetenca të reja, procedura të reja për realizimin e tyre, definim të ri të marrëdhënieve reciproke në mes të organeve të reja të pushtetit publik dhe kështu me radhë. Ky tip i kushtetutës është i kundërt me kushtetutën konstituive apo kushtetutën e plotë, sepse i mungon elementi kyç i arritjes së konstitucionalizmit modern, që ka të bëjë me faktin se kushtetuat rregullojnë (normojnë) në mënyrë gjithëpërfshirëse marrëdhëniet e pushtetit, origjinën dhe mënyrën e ushtrimit të tij. Kjo ndodh zakonisht me sistemet politike në të cilat e drejta për të sunduar apo qeverisur i paraprinë kushtetutës, përkatësisht me vendet ku kushtetuta nuk vjen si rezultat i një revolucioni apo i ndonjë ndërprerjeje radikale me të kaluarën. Në këto raste, kushtetuta luan rolin e modifikuesit të sistemit ekzistues politik, duke lënë të qeta format tradicionale të mbajtjes dhe ushtrimit të pushtetit, kur sundimtarët apo qeveritarët në mënyrë vullnetare pajtohen për të normuar me kushtetutë disa prej mënyrave të ushtrimit të pushtetit. Të kësaj natyre janë, ta zëmë, krejt kushtetutat gjermane të shekullit XIX, kartat kushtetuese franceze të po këtij shekulli, si dhe **Statuti Albertino i Italisë** (1848). Në Ballkan, e këtij lloji ka qenë edhe **Kushtetuta e Jugosllavisë** mbretërore e vitit 1931, e dhuruar nga mbreti **Aleksandri i parë Karagjorgjeviq** (Aleksandar I Karađorđević: 1888-1934).

Edhe **paktet kushtetuese** mund të thuhet se i takojnë historisë, kur në një kohë të caktuar kanë shërbyer për të kufizuar pushtetin absolut të sundimtarit. Kanë qenë karakteristikë e periudhave të përshtatjes së monarkive ndaj parimit të sovranitetit popullor. Në këto kushtetuta merr pjesë organi përfaqësues, sikundër u tha, krahas monarkut, me të cilin kanë autorizime të njëjta. Në fakt, ky i fundit shërben si vërtetues i vullnetit të përfaqësuesit të sovranit-parlamentit. Këtu miratimi i kushtetutës bëhet nga parlamenti, kurse hyrja e saj në fuqi lidhte me nënshkrimin (miratimin) e sundimtarit (kurorës). Më këso kushtetuta janë themeluar monarkitë parlamentare që akoma ekzistojnë në Evropën e sotme.

Kushtetuat e sotme janë kushtetuta demokratike, me përjashtime të rralla, siç është rasti me **Kushtetutën e Bosnje-Hercegovinës**, e cila është pjesë e **Marrëveshjes së Dejtonit** dhe mund të quhet "e dhuruar", thënë kushtimisht. Në fakt, më mirë mund të thuhet se përfaqëson një kushtetutë të ndërkombëtarizuar, sepse në tërësi procedura e krijimit të saj ka qenë e ndërkombëtarizuar dhe është pjesë e një traktati ndërkombëtar. I njëjtë me këtë ka qenë **Statuti organik i Shqipërisë**, një akt që ishte hartuar nga **Komisioni ndërkombëtar i kontrollit** më 10 prill 1914 dhe njihet si kushtetuta e parë e shtetit shqiptar pas shpalljes së pavarësisë.

Bazuar në kriterin e ndërlikueshmërisë së procedurës së kushtetutëbërjes, kushtetutat ndahen në **kushtetuta të ngurta** dhe **kushtetuta fleksibël** (të buta). Këtë ndarje për herë të parë e gjejmë te **Lordi Xhejms Brys**, sipas shënimeve të **A. V. Dajsi**.[336] Deri te kjo ndarje, **Lordi Xh. Brys** kishte ardhur gjatë kritikës së tij të ndarjes klasike në kushtetuta të shkruara dhe kushtetuta të pashkruara, kritikë që u ndërtua mbi bazën e dy argumenteve. Së pari, kushtetutat e pashkruara që kanë origjinën në zakon, më vonë kanë përfshirë në vete edhe ligje të shkruara: në momentin kur shkruhet një zakon, ai më nuk mund të cilësohet si pjesë e kushtetutës së pashkruar për shkak se ka marrë formën me shkrim. Argumenti i dytë i kritikës së ndarjes së kushtetutave në të shkruara dhe të pashkruara bazohet në atë se, të gjitha kushtetutat e shkruara, që janë të vëna në një dokument special (apo në disa sosh), ngërthejnë në vete edhe ndonjë element të zakonit të pashkruar.[337] Në vend të këtyre argumenteve, duke u bazuar në praktikën e hershme romake, **Lordi Xh. Brys** u fokusua në procedurën dhe formulën për amendmanetim kushtetues. Ky fokus zbuloi kategorinë e **kushtetutave rigjide**, të cilat qëndrojnë mbi ligjet tjera të vendit, nisur nga fakti se procedura për amendamentim të tyre është më e komplikuar se ajo që përdoret për ligjet e zakonshme. Përveç kësaj, këto kushtetuta kanë fuqi më të madhe normative se ligjet e zakonshme, fuqi që nuk buron nga të njëjtat autoritete politike që kryejn ligjvënien e zakonshme: organet e kushtetutëbërjes formohen dhe thirren posaçërisht për të ushtruar funksionin e kushtetutëbërjes, pas së cilit proces shuhen ose kthehen në funksionin e tyre të mëhershëm. Shpallja, shfuqizimi apo amendamentimi i tyre nuk bëhet sipas të njëjtës procedurë që vlen për ligjet e zakonshme: në dy rastet ekziston një organ tjetër që nuk është ligjvënës i zakonshëm dhe i cili nuk vepron sipas procedurave për ligjvënie të zakonshme.[338]

Këto shtjellime të zbuluesit të kësaj ndarjeje të kushtetutave kanë kumbim të zëshëm edhe sot e kësaj dite: kushtetutat e buta miratohen dhe ndryshohen sikur ligjet, në një procedurë që nuk është më e komplikuar se ligjbërja. Kjo është ndryshe me kushtetutat e ngurta, të cilat ndryshohen sipas procedurës më të komoplikuar se ajo e ligjbërjes. Në rastin e miratimit të kushtetutës së parë, kjo procedurë mund të mos jetë e komplikuar, përkatësisht mund të jetë miratim me një shumicë të thjeshtë ose më një shumicë absolute. Këtë e shohim të ketë ndodhur mjaft shpesh në të kaluarën, kur shtete kanë miratuar kushtetutat e para me një shumicë të thjeshtë ose absolute, siç ka qenë edhe rasti me **Kosovën** dhe **Maqedoninë e Veriut** (**Shqipëria** dhe **Serbia** kanë miratuar kushtetutat e tyre me referendum; **Mali i Zi** ka miratuar Kushtetutën e vitit 2006 me shumicë të kualifikuar prej dy të tretave).

Kushtetuta mund të ketë ngurtësi të niveleve të ndryshme, në vartësi të asaj se sa e komplikuar është procedura e kushtetutëbërjes. Elementet që e bëjnë një kushtetutë të ngurtë janë: subjektet e posaçme për vënien në lëvizje të procedurës, shumë faza të shqyrtimit saj, votimi shumëfishtë, shumica më e rreptë për miratimin e aktit të ndryshimit, organi posaçëm i vendosjes për miratimin dhe, së fundi, referendumi. Procedurat kërkuese të kushtetutëbërjes mbrojnë kushtetutën nga ndryshimet e shpeshta dhe ndikojnë në stabilitetin e rendit kushtetues. Duhet vënë në dukje, megjithatë, se lehtësia e ndryshimit të kushtetutës nuk varet vetëm në procedurat e komplikuara të kushtetutëbërjes, por edhe nga disa faktorë të tjerë politikë, sociologjikë, historikë, ekonomikë, kulturorë dhe kështu me radhë. Se kjo është kështu dëshmohet nga historia kushtetuese britanike: është treguar më e vështirë të ndryshohet kushtetuta britanike se sa plot kushtetuta të tjera të ngurta, veçanërisht pjesa e saj e pashkruar ku janë të rrënjosura zakone dhe konventa kushtetuese.

8. Struktura dhe renditja e kushtetutës, me vështrim të posaçëm në Kushtetutën e Kosovës dhe kushtetutat e vendeve përreth saj

Kushtetutat ndahen në disa njësi më të ngushta. Si akte juridike, ato kanë vëllime të ndryshme që formohen sipas ngjashmërisë tematike të materies kushtetuese që kodifikohet me to. Sistematika e kushtetutës përbëhet nga njësitë e sistematizimit, në të cilat gjenden një ose më shumë norma kushtetuese. Sipas radhitjes nga më

[336] Albert Venn Dicey, *Introduction to the Law of the Constitution* (Liberty Classics: Indianapolis, 1982), fq. 66 (fusnota 42).
[337] James Bryce, "Flexible and Rigid Constitutions". *Studies in History and Jurisprudence* Vol. I (1901) fq. 124-215 në fq. 127.
[338] Ibid., fq. 129-130; James Bryce, *Constitutions* (Oxford University Press, American Branch: New York, 1905), fq. 7–11.

e vogla kah më e madhja, ato njësi janë: **nenet**, **paragrafët**, **pikët** dhe, në fund, **vijat**. Këto njësi të vogla më pastaj grumbullohen në **pjesë** (në disa kushtetuta), **kapituj**/**krerë**, **seksione** dhe, në fund, **nënseksione**. Kjo është një strukturë standarde e një pjese bukur të madhe të kushtetutave. Vetë struktura dhe vëllimi i kushtetutës, ndërkaq, sidomos i pjesës normative të saj, varen, si**ç** e thotë prof. **Kurtesh Salihu**, nga forma e rregullimit shtetëror (shteti unitar apo i përberë), mendimi i kushtetutëbërësit, teknika juridike etj.[339]

Dy janë pjesët kryesore të një kushtetute, në pjesën më të madhe të tyre: **preambula** dhe **pjesa normative**. Në diskursin laik, këto zakonisht cilësohen si pjesa jooperative apo preambula dhe pjesa operative apo normativa e kushtetutës. Përveç trupit të kushtetutës, i përbërë nga këto dy pjesë, ekzistojnë edhe amendamentet dhe pjesë të tjera të kushtetutës (shtojcat, anekset, apendikset), të cilat i diskutojmë në vijim.

Preambula është pjesa hyrëse e kushtetutës. Sikur parathënia e një libri, ajo i paraprinë kushtetutës dhe tregon për krijuesin dhe arsyet e miratimit të saj (lat.: **praeambulum**-që i paraprinë). Në parim, në të shumtën e rasteve preambula nuk konsiderohet pjesë e kushtetutës, prandaj edhe nuk e përmbajnë të gjitha kushtetutat. Gjithashtu ekzistojnë kushtetuta që nuk e përdorin fjalën preambulë por një shprehje tjetër: Proklamacion kushtetues (Egjipti), Themelet burimore (Kroacia) ose Preambula-themelet kushtetuese (Tanzania). Preambula është një tërësi e veçantë, e cila në kushtetutë është e vendosur pas emrit "kushtetutë" (ani se ka raste kur përbën pjesë shprehimore të kushtetutës, siç janë, ta zëmë, kushtetutat e Turqisë, Kroacisë dhe Serbisë) ose, shumë më rrallë, para këtij emri (siç është rasti, ta zëmë, me kushtetutat e Maqedonisë së Veriut dhe Mali i Zi). Kjo vendosje mund të jetë e rëndësishme me rastin e vlerësimit të fuqisë juridike të preambulës. Ajo mund të paraqitet si burim i drejtpërdrejtë i të drejtave të ekzekutueshme. Kjo mund të bëhet qoftë për shkak se një gjë të tillë e përcakton në mënyrë shprehimore kushtetuta e vendit apo për arsye se një status të tillë preambula e ka fituar përmes praktikës së gjykatës kushtetuese (apo gjykatës tjetër të barasvlershme me të). Si shembull për ilustrim të rastit të parë është **Kameruni**: Kushtetuta e këtij vendi në nenin 65 përcakton se preambula është pjesë e pandarë e saj dhe burim i të drejtave të njeriut të përcaktuara në katalogun e saj.[340] Në të shumtën e rasteve kushtetutat nuk ua njohin preambulave fuqinë normative. Në literaturë, megjithatë, janë shënuar rastet kur ato kanë fituar këtë fuqi normative dhe kanë shërbyer si parametër për vlerësim të kushtetutshmërisë, siç janë rastet me **Kushtetutën e SHBA-së**, **Kushtetutën e Francës** (1958), **LTH** dhe **Kushtetutën e Indisë** (1949). Gjykatat kushtetuese (apo gjykatat tjera të barasvlershme me to), në disa vende evropiane kanë konstatuar se preambulat luajnë në interpretimin e pjesës normative të kushtetutës. Me këtë hap, gjyqësori nacional i ka dhënë kuptim normativ preambulës nacionale, pa marrë parasysh heshtjen lidhur me këtë që mund të ketë ekzistuar në kohën e miratimit të kushtetutave të këtyre vendeve.[341] Në këtë grup vlen të përmenden praktikat gjyqësore në vendet si: **Estonia**,[342]**Maqedonia e Veriut**,[343]**Ukraina**,[344]etj. Rastet si më sipër, sikundër shihet, përfaqësojnë situatat kur preambula nuk paraqet burim autonom të së drejtës kushtetuese, i përcaktuar me kushtetutë, por një status të tillë të burimit e fiton përmes interpretimit deduktiv të dispozitave të pjesës normative të kushtetutës duke përdorur preambulën si parametër së bashku me pjesën normative.

Si në rastin kur preambula nuk ka fuqi autonome juridike ashtu edhe në rastet kur ajo përfaqëson një tekst juridikisht të detyrueshëm së bashku me pjesën normative të kushtetutës, ajo ka për funksion pri-

339 Kurtesh Salihu, *E drejta kushtetuese*, fq. 54.

340 Neni 65 ["Dispozitat Speciale"] i **Kushtetutës së Kamerunit**: "Preambula do të jetë pjesë e pandarë e kësaj Kushtetute ". **Cameroon's Constitution of 1972 with Amendments through 2008.** https://www.constituteproject.org›Cameroon_2008 (shikuar në mars 2022).

341 Vladimir Mikić, "Funkcije preambula savremenih ustava". *PRAVNI ZAPISI* God. V br. 2 (2014) fq. 432-447 në fq. 437.

342 Cf. Liav Orgad, "The preamble in constitutional interpretation". *International Journal of Constitutional Law* Vol. 8 No. 4 (2010) fq. 714–738 në fq. 724.

343 Cf. Ibid., fq. 725 (fusnota nr. 76). Ky autor i referohet dhënësit të verdiktit si "Gjykata Supreme e Maqedonisë", kurse në fakt bëhet fjalë për **GJKMV.** Vendimi në fjalë është botuar në **CODICES** të **Komisioni ttë Venecias**. Cf. MKD-2001-1-004 (Official Gazette) 27/2001, CODICES database. Në internet: http://www. codices. coe. Int /NXT/ gateway.dll/CODICES/precis/eng/eur/mkd/mkd-2001-1-004 (shikuar në mars 2022).

344 Cf. Liav Orgad, "The preamble in constitutional interpretation", fq. 725.

mar të shërbejë si instrument ndihmës dhe udhëzues për interpretim të pjesës operative të kushtetutës dhe plotësim të zbrazësive juridike. Kjo detyrë normative është më e theksuar kur urdhri i tillë vjen nga vetë kushtetuta, e cila, në disa vende, ia njeh preambulës cilësinë e tekstit juridikisht të detyrueshëm. Në këtë kuptim, ekziston një trend në rritje i kushtetutave që në pjesën normative ua njohin preambulave cilësinë e pjesës së detyrueshme të kushtetutës, me fuqi normative të njëjtë me pjesët tjera të kushtetutës. Të tilla janë, ta zëmë, rastet e shteteve si vijon: **Burkina Faso**,[345] **Çadi**,[346] **Hungaria**,[347] **Indonezia**,[348] **Kameruni**,[349] **Komora**,[350] **Siria**,[351] **Togo**,[352] **Turqia**[353] etj. U mor vesh, kjo nuk ka të bëjë me ato pjesë të preambulës që flasin për historinë e lindjes së shtetit dhe kushtetutës si dhe me pjesët tjera deklarative që flasin për traditat nacionale të natyrës politike, kulturore, kushtetuese dhe të tjera të një vendi e që nuk mund të operacionalizohen si detyra normative. Vetëm pjesët apo elementet konkrete të preambulave kanë një natyrë të tillë të detyrueshme, aty ku kushtetutat e thonë një gjë të tillë.

Aty ku nuk e thonë, përkatësisht aty ku kushtetutat janë të heshtura, atëherë vlen rregulli sipas të cilit preambulat janë instrument ndihmës i interpretimit kushtetues. E thënë me fjalë të tjera, në rastet kur kushtetuat nuk përcaktojnë fuqi të detyrueshme normative për preambulat, atëherë vlen rregulli i përgjithshëm se funksioni primar juridik i preambulës është të shërbejë si instrument ndihmës për interpretim të pjesës normative të kushtetutës dhe të plotësoj zbrazëtirat juridike.

Përdorimi i preambulave gjatë interpretimit të kushtetutës, në dy variantet si më sipër, nga konstitucionalisti i njohur italian **Justin O. Frosini** është cilësuar si "qershia mbi tortë", në kuptimin që ato përdoren me qëllim të përligjësimit të një vendosjeje që bazohet në dispozita kushtetuese krejtësisht konkrete nga pjesa normative e kushtetutës. Me fjalë të tjera, sipas këtij autori, preambulat citohen si një dekor për vendimmarrjen që bazohet në dispozita konkrete të pjesës normative të kushtetutës.[354]

---

345 **Kushtetuta e Burkina Faso, Preambula** (paragrafi i fundit i Preambulës në mënyrë shprehimore e thotë se ajo është pjesë integrale dhe e pandarë e Kushtetutës). **Burkina Faso's Constitution of 1991 with Amendments through 2012.** Në internet: https://www.constituteproject.org › constitution (shikuar në mars 2022).

346 **Kushtetuta e Cadit, Premabula** (në mënyrë krejt të njëjtë si Burkina Faso përdoret fjalia që thotë se Preambula është pjesë integrale dhe e pandarë e Kushtetutës). **Chad's Constitution of 1996 with Amendments through 2015.** Në internet: *https://www.constituteproject.org* › Chad_2015 (shikuar në mars 2022).

347 **Kushtetuta e Hungarisë, Preambula** (neni "R" nën pikën 3 flet për interpretimin e Kushtetutës, duke u bazuar në qëllimin e dispozitave të saj, betimin nacional dhe kushtetutën historike; koncepti i fundit i përket shprehjes preambulore, përkatësisht pikat shtatëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë të paragrafit të dytë të saj; me këtë shprehje nënkuptohet kontinuiteti shtetëror-politik, kushtetues dhe kulturor i hungarezëve me strukturat shtetërore, kushtetuese dhe kulturore nga e kaluara e largët, me fillim që nga Mesjeta). **Hungary's Constitution of 2011**. Në internet: *https://www.constituteproject.org* › Hungary_2011 (shikuar në mars 2022).

348 Neni II ["Dispozitat Shtesë"] i **Kushtetutës së Indonezisë**. *The 1945 Constitution of the Republic of Indonesia (last amended 2002).* Në internet: https://www.refworld.org/docid/46af43f12.html.

349 Neni 65 ["Dispozitat Speciale "] i **Kushtetutës së Kamerunit**. **Cameroon's Constitution of 1972 with Amendments through 2008**.

350 **Kushtetuta e Komoros, Preambula** (në paragrafin e fundit thuhet shprehimisht se Preambula është pjesë integrale e Kushtetutës.) **Comoros's Constitution of 2018**. Në internet: *https://* www.constituteproject*. org* › Comoros_2018 (shikuar në mars 2022).

351 Neni 151 ["Dispozitat e Përgjithshme dhe Kalimtare"] i Kushtetutës së Sirisë. *Constitution of the Syrian Arab Republic – 2012*. Në internet: https://www.constituteproject.org › Syria_2012 (shikuar në mars 2022).

352 **Kushtetuta e Togos, Preambula** (në paragrafin e fundit thuhet shprehimisht se Preambula është pjesë integrale e Kushtetutës). **Togo's Constitution of 1992 with Amendments through 2007**. Në internet: https://www. constituteproject.org/constitution/Togo_2007.pdf?lang=en (shikuar në mars 2022).

353 Neni 176.1 ["Preambula dhe titujt e artikujve"] i Kushtetutës thotë se preambula, me të cilën përcaktohen pikëpamjet dhe parimet e Kushtetutës, formon pjesë integrale të Kushtetutës. **Turkey's Constitution of 1982 with Amendments through 2017**.

354 Justin O. Frosini, *Constitutional Preambles: At a Crossroads between Politics and Law* (Maggioli: Santarcangelo di Romagna, Italia, 2012), fq. 82–83 (ky cilësim ka marrë si shkas jurisprudencën e GJKGJE, e cila kishte përdorur preambulën në dy raste për të treguar zotimet gjermane ndaj të drejtës ndërkombëtare dhe ndërtimit të paqes në botë, por në fakt **ratio decidenti** kishte të bënte me dispozita të tjera konkret kushtetuese, me nene krejt tjera që kishin shërbyer si bazë për vendosjen e rasteve; dmth preambulat kanë shërbyer në këto dy raste si "qershia mbi tortë" për të arsyetuar një përmbajtje që në thelb bazohet në dispozitat të tjera konkrete të kushtetutës).

Sipas formës, preambula është një fjali e përbërë, shumë e gjatë në rastet më të shpeshta, e ndarë sipas rregullit në qëndrime të gjatësisë deri në treqind fjalë. Më e shkurtër është preambula në **Kushtetutën e Greqisë** (1975), që thotë "Në emër të trinitetit të shenjtë, të pandashëm dhe konsubstancial", kurse më e gjata në kushtetutat e **Iranit** (3.073 fjalë) dhe **Kinës** (1.707 fjalë). Sipas përmbajtjes, ndërkaq, preambula është e ndryshme krahasuar me pjesën normative: në të përmenden rrethanat shoqërore, politike, vlerat individuale, demokracia, drejtësia, sovraniteti, pavarësia, integriteti territorial, barazia, të drejtat e njeriut, harmonia, mençuria, besnikëria, fati dhe kështu me radhë.

Në preambula gati çdo herë tregohet kushtetutëbërësi, populli ose kombi (**Franca, Hungaria, India, Rusia, Spanja, SHBA**) apo qytetari. Në disa vende kushtetuta miratohet në emër të Zotit ose para **Zotit** (**Gjermania**, **Zvicra**). Në preambula thirret në një religjion të caktuar (tipike për vendet e **Amerikës Latine**, vendet **Islamike**), traditë, histori, përmenden personalitet historike dhe sundimtarë. Më këtë preambula i jep legjitimitet dhe mbështetjeje kushtetutëbërësit për të miratuar pikërisht një kushtetutë të tillë që reflekton atë që thuhet në të.

Preambulat përmbajnë dispozita ideologjike, qoftë duke kritikuar regjimin pararendës politik përmes shpalosjes së historisë politike të vendit (Kushtetuta e Kinës: rrëzimi i imperializmit sundues, feudalizmit dhe kapitalizmit burokratik) apo duke treguar se çfarë regjimi politik po themelohet me kushtetutën e re (**Kushtetuta e Spanjës**: demokracia).

Preambulat tregojnë qëllimet shoqërore që synohet të arrihen me kushtetutë: drejtësia, liria e mendimit, barazia, vëllazëria (**India**), paqja botërore (**Gjermania**), mirëqenia e qytetarëve (**Spanja**), fuqizimi i lirisë, demokracisë, pavarësisë, paqes dhe solidaritetit në frymën e hapjes ndaj botës (**Zvicra**). Këto qëllime nganjëherë janë të lidhura me probleme të mëdha politike, siç është rasti i Kinës me **Tajvanin** (në aspektin juridik-ndërkombëtar **Tajvani** si vend konsiderohet pjesë e Kinës, sipas formulës "një vend, dy sisteme").

Pjesa normative e kushtetutës përmban norma kushtetuese që janë të sistemuara në nene. Neni ("article") njësia themelore e sistemimit. Neni ka një ose disa rregulla (norma) dhe rregullon një ose disa çështje: parim kushtetues, të drejtë të njeriut, kompetencë të një organi të pushtetit. Neni mund të ketë emërtim, që shënohet me numër arab, më rrallë me numra romakë (SHBA), por mund të shënohet dhe më shkronja apo me kombinim të numrave dhe shkronjave (**Kushtetuta e Hungarisë** për shënimin e neneve përdor germat, pastaj numrat romakë dhe në fund numrat arabë).

Neni ka një ose më shumë paragrafë. Paragrafi ("paragraph") është pjesë e nenit që është i sistemuar në një rend (kryerresht) të ri. Paragrafi mund të ketë një ose më shumë pikë ("point"), të cilat shënohen me numra ose germa, dhe një ose disa **vija** ("line"). Në pika dhe vija numërohen kompetencat e organeve, arsyet për shkarkim dhe gjëra të ngjashme me këto. Pra, radhitja e zakonshme është kjo: neni, **paragrafi**, **pika** dhe, në fund, **vija**. Këto njësi të vogla më pastaj grumbullohen në **pjesë** (në disa kushtetuta), **kapituj**/**krerë**, **seksione** dhe, në fund, **nënseksione**. **Pjesa** ("part") përfshinë nenet nga fushat më të gjëra tematike- parime, të drejtat dhe liritë e njeriut, organizimi i pushtetit dhe kështu me radhë. **Kapitujt**/**krerët**, **seksionet** dhe, në fund, **nënseksionet** janë njësi më të vogla të sistemimit krahasuar me **pjesët** dhe përfshijnë **nenet** që kanë të bëjnë me subjektin apo institutin e njëjtë-shefin e shtetit, ekzekutivin, mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, rendin ekonomik dhe kështu me radhë. Të rralla janë kushtetutat që kanë nenin për njësi sistemimi më të gjerë. Atëherë ai përbëhet nga një ose disa krerë apo seksione me një numër më të madh të normave (Bosnjë-Hercegovina dhe SHBA).

Radhitja e temave të **materies kushtetuese** ose e pjesëve të tëra, kapitujve apo krerëve flet për rëndësinë e materies kushtetuese në një kushtetutë. Kjo nuk do të thotë se pjesët e caktuara të materies kushtetuese kanë fuqi më të madhe juridike se të tjerat, por vetëm tregon për rëndësinë që kushtetutëbërësi ka dashur t'u jep disa normave kushtetuese. Kushtetutat, megjithatë, në të shumtën e rasteve nisin me dispozita apo parime të përgjithshme, dhe mbyllet me dispozita të kalimtare dhe të fundit. Rëndësia më e madhe që

kushtetutëbërësi u ka dhënë në renditje parimeve kushtetuese vërtetohet me faktin se ato shërbejnë si levë mbështetëse për interpretim të pjesëve të tjera të kushtetutës.

Në strukturën e disa kushtetutave hyjnë edhe **shtojcat/anekset** (India, Nigeria, Zimbabve). Ato sipas rregullit miratohen së bashku me kushtetutën por janë tërësi të ndara, me qëllim të shkarkimit të tekstit themelor të kushtetutës. Ato përplotësojnë dhe konkretizojnë dispozitat kushtetuese nga teksti themelor i kushtetutës. Kështu, ta zëmë, në **Kushtetutën e Indisë** kanë të bëjnë me 22 shtete, 9 territore federale, 23 gjuhë zyrtare, ligjet që zbatohen dhe çështje të tjera të ndryshme. Shtojcat/anekset sistemohen në fund të kushtetutës.

Amendamentet në kushtetutë (te kushtetutat që kanë pësuar ndryshime), sistemohen më pas në fund të kushtetutës në një tërësi të vetme. Amendamentet mund të futen në kushtetutë në vend të dispozitës së mëhershme që ka ndryshuar dhe, kësisoj, ka pushuar të ekzistojë.

Kushtetuta e Kosovës ka këtë strukturë: pjesën jo operative apo preambulën, pjesën operative apo qendrore, pjesën përfundimtare dhe kalimtare dhe, së fundi, njëzetë e pesë amendamentet e saj.

Në preambulë jepen synimet dhe orientimet e përgjithshme të Shtetit të Kosovës në raport me vetveten dhe botën që e rrethon.

Në pjesën e parë të pjesës operative jepen parimet themelore të cilat definojnë natyrën, pozitën, formën dhe përmbajtjen e shtetit të Kosovës, rolin dhe pozitën e individit në shoqëri[355]. Pas kësaj vijnë, konform traditës së nisur me **Kushtetutën e Vajmarit** (1919), dispozitat e kapitujve mbi liritë dhe të drejtat e njeriut[356]. Si rezultat i instalimit të demokracisë konsociacionale, në Kosovë ekziston një kapitull shtesë mbi liritë dhe të drejtat e komuniteteve[357]. Krejt natyrshëm, kjo pjesë pasohet me kapitujt që normojnë organizimin e pushtetit dhe mënyrën e ushtrimit të tij. Këtu vijnë në shprehje në rend të parë dispozitat mbi organizimin e pushtetit në nivel qendror (Kuvendi[358], Presidenti[359], Qeveria[360], Sistemi i Drejtësisë[361] dhe Gjykata Kushtetuese[362]). Këto më pas pasohen nga dispozitat mbi organizimin e pushtetit lokal[363], organizimin dhe ushtrimin e autoritetit nga ana e institucioneve të pavarura[364] dhe atyre të sigurisë[365], përfshirë vendin dhe rolin e tyre në sistemin kushtetues. Një pjesë e mirë e dispozitave kushtetuese i kushtohen marrëdhënieve ekonomike[366] dhe profesioneve të pavarura[367]. Fare në fund janë dispozitat kalimtare dhe të fundit.[368] Dispozitat kalimtare janë fshirë me amendamentet kushtetuese me të cilat është mbyllur pavarësia e mbikëqyrur dhe, si të tilla, i takojnë historisë: dispozitat e këtij kapitulli kanë rregulluar situatën e pavarësisë së mbikëqyrur e cila ka mbaruar në shtator të vitit 2012.

Amendamentet I-XXII kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare te pavarësisë së Kosovës.[369] Amendamenti XXIII ka të bëjë me amnistinë, e cila nuk ka qenë e njohur me Kushtetutën e Kosovës kur është miratuar (sic!). [370] Amendamenti XXIV ka themeluar Dhomat e Specializuara dhe

355 Kapitulli I: Dispozitat Themelore (nenet 1-20) i Kushtetutës.
356 Kapitulli II: Të Drejtat dhe Liritë Themelore (nenet 21-56) i Kushtetutës.
357 Kapitulli III: Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre (nenet 57-62) i Kushtetutës.
358 Kapitulli IV: Kuvendi i Republikës së Kosovës (nenet 63-82) i Kushtetutës.
359 Kapitulli V: Presidenti i Republikës së Kosovës (nenet 83-91) i Kushtetutës.
360 Kapitulli VI: Qeveria e Republikës së Kosovës (nenet 92-101) i Kushtetutës.
361 Kapitulli VII: Sistemi i Drejtësisë (nenet 102- 111) i Kushtetutës.
362 Kapitulli VIII: Gjykata Kushtetuese (nenet 112-118) i Kushtetutës.
363 Kapitulli X: Qeverisja Lokale dhe Organizimi Territorial (nenet 123-124) i Kushtetutës.
364 Kapitulli XII: Institucionet e Pavarura (nenet 132-142) i Kushtetutës.
365 Kapitulli XI: Sektori i Sigurisë (nenet 125-131) i Kushtetutës.
366 Kapitulli IX: Marrëdhëniet Ekonomike (nenet 119-122) i Kushtetutës.
367 Kapitulli VII: Sistemi Drejtësisë (neni 111, Avokatura) i Kushtetutës.
368 Kapitujt XII & XIV: Dispozitat Përfundimtare dhe Kalimtare (nenet 143-162) i Kushtetutës.
369 **Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës** nr. 25 datë 7 shtator 2012.
370 **Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës** nr. 7 datë 26 mars 2013.

Zyra e Prokurorit të Specializuar. [371]Amendamenti XXV ka ndryshuar përbërjen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke e rritur numrin e gjyqtarëve të karrierës në dëm të përbërjes politike.[372]

KShq ka këtë strukturë: preambulën, pjesën operative, pjesën kalimtare dhe, së fundi, një aneks. Që nga nxjerrja e saj në vitin 1998, **KShq** ka pësuar ndryshime gjashtë herë, më të thellat dhe më rrënjësoret duke qenë ato që kanë të bëjnë me procesin e njohur si **Vetingu shqiptar**.[373] Pjesa e parë, përfshinë parimet themelore. Këtu jepet shkurtimisht fytyra e Shtetit shqiptar, forma dhe karakteri i Shteti dhe pushtetit, roli dhe pozita e fesë dhe individit, origjina e sovranitetit dhe mënyra e ushtrimit të tij, orientimi ndërkombëtar i Shtetit dhe kështu me radhë.[374] Pjesa e dytë përbëhet prej gjashtë krerëve:[375] kreu i parë merret me parimet e përgjithshme të kësaj pjese;[376] i dyti, me liritë dhe të drejtat personale;[377] i treti, me liritë dhe të drejtat politike;[378] i katërti me liritë dhe të drejtat ekonomiko-sociale dhe kulturore;[379]i pesti, me objektivat sociale që Shteti shqiptar ia ka vënë vetes përpara; së fundi, i gjashti merret me Avokatin e Popullit.[380] Pjesa e tretë rregullon Kuvendin,[381] dhe ka katër krerë: i pari normon zgjedhjen dhe afatin;[382] i dyti me deputetët;[383] i treti me organizimin dhe funksionimin e pushtetit;[384] dhe, së fundi, i katërti me procesin ligjvënës.[385] Pjesët katër, pesë dhe gjashtë normojnë nga një organ qendror kushtetues dhe qeverisjen vendore.[386] Pjesa e shtatë, në dy kapituj, normon aktet normative dhe marrëveshjet ndërkombëtare.[387] Pjesët tetë deri njëmbëdhjetë përmbajnë norma kushtetuese për organe të posaçme kushtetuese të drejtësisë shqiptare dhe referendumin.[388] Pjesa që pason është shfuqizuar. [389]Pjesa e trembëdhjetë merret me Financat publike,[390] kurse e katërmbëdhjeta me Kontrollin e lartë të shtetit.[391] Pjesa e pesëmbëdhjetë flet për forcat e armatosura,[392]e pasuar natyrshëm nga normimi i gjendjes së jashtëzakonshme.[393]Pjesa e shtatëmbëdhjetë i kushtohet rishikimit të **KShq**.[394] Pjesa e fundit, e tetëmbëdhjete përmban dispozitat kalimtare dhe të fundit.[395] Aneksi, i shtuar me ndryshimet kushtetuese që kanë të bëjnë me **vetingun shqiptar**, mban titullin "Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve".[396]

---

371 **Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës** nr. 20 datë 5 gusht 2015.
372 **Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës** nr. 9 datë 11 mars 2016.
373 Ndryshimet e **KShq** janë bërë me ligjet për sa vijon: Ligji nr. 9675, datë 13.1.2007; Ligji nr. 9904, datë 21.4.2008; Ligji nr. 88/2012, datë 18.09.2012; Ligji nr. 137/2015, datë 17.12.2015; Ligji nr. 76/2016, datë 22.07.2016; dhe Ligji nr. 115/2020, datë 30.07. 2020.
374 PJESA E PARË (Parime themelore: nenet 1-14).
375 PJESA E DYTË (Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut: nenet 15-63).
376 KREU I (Parime të përgjithshme: nenet 15-20).
377 KREU II (Liritë dhe të drejtat vetjake: nenet 21-44).
378 KREU III (Liritë dhe të drejtat politike: nenet 45-48).
379 KREU IV (Liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore: nenet 49-58).
380 KREU VI (Avokati i popullit: 60-63).
381 PJESA E TRETË (Kuvendi: nenet 64-85).
382 KREU I (Zgjedhja dhe afati: nenet 64-67).
383 KREU II (Deputetët: nenet 68-73).
384 KREU III (Organizimi dhe funksionimi: nenet 74-80).
385 KREU IV (Procesi ligjvënës: nenet 81-85).
386 KREU IV (Procesi ligjvënës: nenet 81-85); PJESA E KATËRT (Presidenti i Republikës: nenet 86-94 40).
PJESA E PESTË (Këshilli i Ministrave: nenet 95-107).
PJESA E GJASHTË (Qeverisja vendore: nenet 108-115).
387 PJESA E SHTATË (Aktet normative dhe marrëveshjet ndërkombëtare: nenet 116-123).
388 PJESA E TETË (Gjykata Kushtetuese: nenet 124-134); PJESA E NËNTË (Gjykatat: nenet 135-147); PJESA E DHJETË (Prokuroria: nenet 148-149); PJESA E NJËMBËDHJETË (Referendumi: 150-152).
389 PJESA E DYMBËDHJETË (Shfuqizuar: nenet 153-154).
390 PJESA E TREMBËDHJETË (Financat publike: nenet 155-161).
391 PJESA E KATËRMBËDHJETË (Kontrolli i Lartë i Shtetit: nenet 162-165).
392 PJESA E PESËMBEDHJETË (Forcat e Armatosura: nenet 166-169).
393 PJESA E GJASHTËMBËDHJETË (Masat e jashtëzakonshme: nenet 170-176).
394 PJESA E SHTATËMBËDHJETË (Rishikimi i Kushtetutës: neni 177).
395 PJESA E TETËMBËDHJETË (Dispozita kalimtare dhe të fundit: nenet 178-183).
396 Është shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016.

KMVer ka këtë strukturë: preambulën, pjesën operative, dispozitat kalimtare dhe të fundit, dhe, së fundi, amendamentet. Në preambulë shpaloset vizioni dhe misioni i Shtetit, orientimet e përgjithshme për ndërtim të një shteti ku respektohet liria e barazia e të gjithëve, bazuar në traditën historike të **Luftës së Dytë Botërore** të kombit sllav maqedono-verior, me popujt tjerë më pak të përmendur, nuk mungojnë zotimet për drejtësinë sociale, por sovraniteti dhe pavarësia ngelen që në fillim qëllimi parësor i konstitutimit të këtij shteti fqinj. Pjesa operative ka tetë pjesë. Pjesa e parë nis me dispozitat themelore, që lexuesi ta ketë të qartë se Maqedonia e Veriut është sovran dhe i pavarur, unitar dhe republikan, territori i të cilit është i pacenueshëm, ka kufij që mund të ndryshohen duke ndjekur procedurat kushtetuese, pastaj flet për simbolet shtetërore, gjuhën dhe kryeqytetin, vetadministrimin lokal dhe vlerat kushtetuese mbi të cilat qëndron tërë rendi juridik-kushtetues.[397] Pjesa e dytë normon liritë dhe të drejtat themelore, përfshirë garancitë e tyre dhe marrëdhëniet ekonomike mbi të cilat bazohet shoqëria.[398] Pjesa e tretë i kushtohet organizimit të pushtetit, që fillon me Kuvendin, Presidentin, Qeverinë, Gjyqësinë dhe Prokurorinë.[399]Pjesa e katërt i dedikohet **Gjykatës Kushtetuese të MVer**, normim ky i ndarë, tipik për vendet që kultivojnë gjyqësi kelseniane/evropiane, që është e ndarë nga gjyqësori i rregullt.[400] Ky i fundit është një pushtet i tretë i ndarë prej gjyqësisë kushtetuese dhe zakonisht nuk figuron bashkë me të. Pjesa e pestë ka të bëjë me qeverisjen vendore, që cilësohet si vetëadministrim lokal.[401] Kjo pjesë pasohet me pjesën e marrëdhënieve ndërkombëtare, rolin dhe pozitën e akteve juridike ndërkombëtare në rendin juridik të këtij vendi.[402] Mbrojtja e Republikës është rregulluar me pjesën e shtatë, ku përfshihen edhe gjendja e luftës dhe gjendja e jashtëzakonshme.[403] Ndryshimi i Kushtetutës është pjesa e parafundit,[404] që pasohet nga dispozitat kalimtare dhe të fundit.[405] Deri më sot, **KMVer** është ndryshuar tridhjetë e gjashtë herë, duke nisur prej ndryshimit të flamurit shtetëror, emrit të Shtetit, çështjes së sigurimit të barazisë së shqiptarëve dhe kështu me radhë.

KMZi ka këtë strukturë: preambulën, pjesën operative, dispozitat kalimtare dhe të fundit dhe, së fundi, amendamentet. Preambula është mjaft e shkurtër, nis me pavarësinë dhe sovranitetin e vendit, liritë dhe të drejtat e njeriut, barazinë e lirinë, kujdesin për ambientin dhe kujdesin për kultivimin e marrëdhënieve të mira me shtetet e popujt tjerë. Pjesa e parë përmban dispozitat e përgjithshme, që definojnë shtetin dhe pushtetin, territorin dhe kufijtë, simbolet shtetërore, kryeqytetin, barazinë, fenë, marrëdhëniet ndërkombëtare, kushtetutshmërinë e ligjshmërinë dhe kështu me radhë.[406] Pjesa e dytë i kushtetohet lirive dhe të drejtave themelore, përmban parimet themelore të tyre, kufizimet dhe llojet, duke ndjekur ndarjen sipas gjeneratave të lirive dhe të drejtave të njeriut, të drejtat e minoriteteve si kategori e veçantë e lirive dhe të drejtave, përfshirë dhe mbrojtjen e tyre.[407] Pjesa e tretë adreson rregullimin e pushtetit dhe fillon me Kuvendin, Presidentin, Qeverinë, Vetëqeverisjen lokale, Gjykatat, Ushtria e Malit të Zi dhe, në fund, Prokuroria Shtetërore. Në dispozitat mbi organizimin e pushtetit, përcaktohen organet dhe kompetencat që ushtrojnë pushtetet, lloji dhe kontrolli, mënyra e frenimit të pushtetit shtetëror, gjendja e luftës dhe gjendja e jashtëzakonshme, e kështu me radhë.[408] Pjesa e katërt është rregullimi ekonomik i vendit, natyra dhe organet që janë të autorizuara për të marrë pjesë në marrëdhëniet ekonomike dhe mënyra e pjesëmarrjes.[409] Pjesa e pestë merret me kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, ku diskutohet hierarkia e akteve juridike, detyrimit për respektim të Kushtetutës dhe supremcisë së saj, ligjeve dhe akteve të tjera që janë pjesë e rendit juridik, ndalimi i retrokativitetit të ligjeve dhe gjëra si këto.[410] Pjesa e gjashtë i kushtohet Gjykatës Kushtetuese të **MZi** dhe nuk dallon shumë si mënyrë

397 DISPOZITA THEMELORE: nenet 1-8.
398 LIRITË DHE TË DREJTAT THEMELORE TË NJERIUT DHE TË QYTETARIT: nenet 9-60.
399 ORGANIZIMI I PUSHTETIT SHTETËROR: nenet 61-107.
400 GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË: nenet 108-113.
401 VETADMINISTRIMI LOKAL: nenet 113-117.
402 MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE: 118-121.
403 MBROJTJA E REPUBLIKËS, GJENDJA E LUFTËS DHE GJENDJA E JASHTËZAKONSHME: nenet 122-128.
404 NDRYSHIMI I KUSHTETUTËS: nenet 129-131.
405 DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE: 132-134.
406 Pjesa parë: Dispozitat themelore, nenet 1-16.
407 Pjesa dytë: Liritë dhe të drejtat themelore, nenet 17-81.
408 Pjesa tretë: Rregullimi pushtetit, nenet 82-138.
409 Pjesa katërt: Marrëdhëniet ekonomike, 139-144.
410 Pjesa pestë: Kushtetutshmëria dhe ligjshmëria, nenet 145-148.

rregullimi kushtetues nga rregullimi i vendeve të tjera përreth **Kosovës**.[411] Pjesa shtatë rregullon ndryshimin e KMZi.[412] Në fund është dispozita kalimtare dhe e fundit që flet për ligjin kushtetues për zbatimin e **KMZi**.[413]

KSerb kanë strukturë mjaft të ngjashme me KMZi, por me një përmbajtje të ndryshme që shfaqet qysh në preambulë. Aty, siç kemi theksuar, Kosova zë vend të veçantë. Në të vërtetë, preambula, që ka një paragraf të gjatë, në pjesën dërrmuese flet për Kosovën, duke vënë detyrim për organet shtetërore që çdo punë të tyre ta shohin në prizmin e Kosovës. Pastaj vjen pjesa e dispozitave themelore, që bëjnë fjalë për shtetin, sovranitetin, simbolet shtetërore, kryeqytetin, gjuhën, barazinë e pakicave dhe mbrojtjen e tyre, autonominë e krahinave, marrëdhëniet ndërkombëtare, fenë, e kështu me radhë.[414] Pjesa e dytë, liritë dhe të drejtat e njeriut e të minoriteteve, nis me parimet e përgjithshme dhe më pastaj normon liritë e të drejtat e njeriut me fillim nga të drejtat e liritë civile dhe politike. **KSerb** nuk ndjek rrugën e kushtetutave të tjera që normojnë liritë e të drejtat e njeriut sipas gjeneratave, duke i ndarë nëpër kapituj apo seksione e nënseksione të posaçme. Të drejtat dhe liritë e minoriteteve dhe mbrojta e tyre garantohet gjithashtu.[415] Sistemi ekonomik dhe financat publike janë ngjeshur në pjesën e tretë dhe ndahet në dy seksione: sistemi ekonomik dhe financat publike.[416] Organizimi i pushtetit shtetëror nuk nis me pjesën e katërt, që i kushtetohet kompetencave të Republikës së Serbisë në përgjithësi, d.m.th. me **KSerb** përcaktohet se çka është kompetencë ekskluzive e Serbisë, çka ndahet me nivelet tjera, përfshirë autonomitë politiko-territoriale dhe qeverisjen kuvendore dhe kështu me radhë.[417] Me këtë pjesë, njëjtë sikur në kushtetutat përreth Kosovës, sanksionohet parimi i ndarjes dhe balancimit i pushtetit në nivelin horizontal dhe vertikal. Pjesa e pestë flet në mënyrë specifike për organizimin e pushtetit. Edhe këtu normimi nis me Kuvendin e Serbisë, gjë që tregon se bëhet fjalë për një sistem parlamentar të qeverisjes, pasohet nga dispozitat mbi Presidentin, Qeverinë, Avokatin e Popullit, Ushtrinë e Serbisë, Gjykatat, Këshillin e Lartë Gjyqësor, Zyrën e Prokurorit Publik dhe Këshillin Prokurorial Shtetëror.[418] Edhe këtu, GJKSerb trajtohet ndaras nga gjyqësori, në pjesën e gjashtë.[419] Pjesa e shtatë është mjaft e strukturuar dhe bënë fjalë për organizimin territorial. Ndahet në disa seksione: autonomia krahinore dhe vetëqeverisja lokale, krahinat autonome dhe vetëqeverisja lokale.[420] Pjesa e tetë, njëjtë si në KMZi, i dedikohet kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, traditë kjo e njësive federale sipas Kushtetutës së ish-Jugosllavisë të vitit 1974.[421] Në pjesën e parafundit vijnë dispozitat e pjesës së nëntë mbi amendamentimin.[422]Në fund janë ato që kanë të bëjnë me dispozitat përfundimtare.[423] Deri më sot **KSerb** është ndryshuare njëzetenëntë herë, duke u nisur që nga dispozitat mbi ndarjen e pushtetit e deri te përbërja, mënyra e zgjedhjes dhe shkarkimit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe çështjet tjera që lidhen me pushtetin gjyqësor dhe sistemin e drejtësisë në përgjithësi. Në të shumtën e rasteve, amendamentimet kushtetuese serbe kanë shkuar për vlerësim në **Komisionin e Venecias**, praktikë kjo e ndjekur edhe nga vendet tjera përreth Kosovës.

9. Shteti dhe parimet themelore të konstitucionalizmit modern

9.1. Shteti dhe ndarjet e tij

Mund të mendohet se ka qenë e drejta ndërkombëtare ajo që së pari ka ndërtuar kriteret apo elementet e qenies shtet. Kjo, në fakt, nuk është kështu. Ka qenë **doktrina austriake e të drejtës publike** ajo që e para ka formuluar kriteret themelore të qenies shtet. Ato kritere, më pastaj, në mes të dy luftërave botërore, e drejta

411 Pjesa gjashtë: Gjykata Kushtetuese, nenet 149-154.
412 Pjesa e shtatë: Ndryshimi Kushtetutës, nenet 155-157.
413 Pjesa tetë: Dispozita kalimtare dhe e fundit, neni 158.
414 Pjesa parë: Parimet kushtetuese, nenet 1-17.
415 Pjesa e dytë: Liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, nenet 18-81.
416 Pjesa e tretë: Sistemi ekonomik dhe financat publike, nenet 82-96.
417 Pjesa e katërt: Kompetencat e Republikës së Serbisë, neni 97.
418 Pjesa e pestë: Organizimi i pushtetit, nenet 98-165.
419 Pjesa e gjashtë: Gjykata Kushtetuese, nenet 167-175.
420 Pjesa shtatë: Organizimi territorial, nenet 176-193.
421 Pjesa e tetë: Kushtetutashmëria dhe ligjshmëria, nenet 194-202.
422 Pjesa nëntë: Amendamentimi i Kushtetutës, nenet 203-205.
423 Pjesa e dhjetë: Dispozita e fundit, neni 206.

ndërkombëtare i ka pranuar e modifikuar dhe, në fund, i ka kodifikuar me aq saktësi, aq shumë sa, aktualisht, ato përfaqësojnë standarde thuajse konsensuale të bashkësisë ndërkombëtare lidhur me atë se çfarë konsiderohet shtet.

Juristi austriak i të drejtës publike, në fakt eksponenti i saj, **Gjorgj Jellinek** ka zhvilluar mësimin mbi tri elementet kosntituive që përbëjnë shtetin dhe pa të cilat ai nuk mund të ekzistojë. Këto elemente, **Jellinek** i ka gjetur përmes studimeve krahasimore të bashkësive politike paramoderne dhe moderne. Ato elemente, sipas tij, janë:

- **territori shtetëror**;
- **populli shtetëror**; dhe
- **pushteti shtetëror**.[424]

Me modifikimet e duhura, si në terminologji ashtu edhe në elementet e saj përbërëse, kjo teori është pranuar gjerësisht në të **drejtën kushtetuese krahasimore** dhe të **drejtën ndërkombëtare**. Në të parën, vetëm sa i përket doktrinës, sepse e drejta pozitive kushtetuese nuk e sanksionon qenien shtet dhe as nuk definon kriteret për një gjë të tillë. Testi dhe treguesi i qenies shtet kryhet e zhvillohet në strukturat normative të marrëdhënieve ndërkombëtare: elementet e shtetit si më sipër, në të drejtën ndërkombëtare përdoren për të përshkruar bashkësitë politike që janë subjekte të së drejtës ndërkombëtare dhe shërben si një standard për të drejtën kushtetuese me rastin e përcaktimit të shtetit në të drejtën e brendshme. Kjo është kësisoj për shkak se, në marrëdhëniet ndërkombëtare, shtetet veprojnë pa pasur një qeveri qendrore që rregullon marrëdhënien në mes tyre. Në shumësinë e shteteve në bashkësinë ndërkombëtare hasen shtete që kanë natyrë e rregullim të ndryshëm kushtetues e politik (autoritare, totalitare, demokratike etj). Kjo situatë kësisoj ka shtruar nevojën që, në mes të dy luftërave botërore, të përqafohet standardi i autorit austriak si më sipër, lidhur me qenien shtet. Sot ai standard shërben si një pikë e fortë nisëse për tipologjinë e shtetit modern dhe qëndron në themel të definimit të shtetit që haset në **Konventa e Montevideos mbi të drejtat dhe detyrat e shteteve** e vitit 1933.

Në nenin e saj të parë përcaktohet se shteti si subjekt i së drejtës ndërkombëtare duhet të posedojë këto cilësi: 1. popullsinë permanente; 2. territorin e definuar; 3. qeverinë (pushtetin); dhe 4. kapacitetin për të hyrë në marrëdhënie me shtetet tjera. Në thelb, kjo është shprehja normative e standardit të juristit austriak **Gj. Jellinek**. Sinteza e elementeve të qenies shtet të përshkruara nga ky autor dhe shprehja e tyre normative në **Konventën e Montevideos** hapin mundësinë për të nxjerr përfundimin se shteti përfaqëson atë bashkësi territoriale të njerëzve që posedon pushtet suprem sovran dhe që ka zotësinë për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e subjektet tjera të së drejtës ndërkombëtare. Cilësia e sovranitetit, apo e pushtetit shtetëror, paraqet një prerogativë që e posedon vetëm shteti, jo organizatat ndërkombëtare. Këto të fundit, ndërkaq, kanë zotësinë për të hyrë në marrëdhënie ndërkombëtare, por nuk janë entitete sovrane. Përveç organizatave ndërkombëtare, nga ky definim i shtetit si entitet sovran përjashtohen edhe subjektet tjera joshtetërore, që mund të pranohen si legjitime në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe në të drejtën kushtetuese nacionale, por që nuk mund të cilësohen si shtete. Këtu kemi parasysh, ta zëmë, lëvizjet kryengritëse, popujt në territoret e pushtuara ushtarakisht, territoret që nuk qeverisen vet apo territoret nën kujdestari dhe kështu me radhë. Përveç këtyre subjekteve të së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, që nuk janë shtete por që kanë status ligjërisht të pranueshëm në të drejtën ndërkombëtare, ekzistojnë edhe subjekte të tjera jo të ligjshme në rendin juridik ndërkombëtar. Të tilla janë, ta zëmë, **lëvizjet terroriste**, **entitetet kuazi-shtetërore që janë rezultat i zbatimit të politikave të gjenocidit dhe aparteidit** dhe kështu me radhë.

Aktualisht përqafohet mendimi se shteti përbëhet nga tri elemente: territori, populllsia dhe pushteti. Të kthehemi tani te **territori shtetëror**, si element material i shtetit. Ai përfaqëson territorin

[424] Cf. më shumë në Georg Jellinek, *Allgemeine Staatslehre*, fq. 394-434 (si dhe kapitujt në vijim ku Jellinek trajton, deri në fund të tyre, tri elementet e shtetit si më sipër).

shtetëror që përkufizohet me kufij. Çdo shtet ka territorin e vet, një hapësirë mbi sipërfaqe dhe çdo gjë që gjendet nën të, pastaj popullsinë që jeton aty dhe, në fund, pushtetin shtetëror që ushtrohet në atë territor. Territori është **element material** i shtetit, për dallim nga popullsia, që përbën **elementin personal**. Elementi i tretë, **pushteti**, lidh dy elementet e tij në një bashkësi të tërësishme të njerëzve. Bashkësia shtetërore dallon nga bashkësitë tjera shoqërore pikërisht për shkak të **pushtetit politik**.

Territori në pjesën dërrmuese të rasteve, normohet me kushtetutë, gjë që flet për rëndësinë e tij. Kështu, ta zëmë, në Francë territorin e përbëjnë **bashkësitë territoriale** (Titulli XIIi Kushtetutës së vitit 1958 flet për komunitetet territoriale, që më pastaj ndahen në njësi të ndryshme), në Zvicër, atë e përbëjnë **kantonet** (Titulli 3 i Kushtetutës së vitit 1999 flet për Konfederatën, Kantonet dhe komunat), në Gjermani-**landet** apo krahinat (Kapitulli II flet për Federatën dhe Landet) dhe kështu me radhë. Ekziston një supozim që madhësia dhe relievi i territorit ndikon apo mund të ndikojë në rregullimin shtetëror: sa më i madh territori, shteti ka rregullim shtetëror të shtetit të përbërë, dhe anasjelltas – sa më i vogël territori, shteti ka rregullim shtetëror unitar.

Popullsia është cilësia e dytë e rëndësishme e shtetit, substrati i saj sociologjik. Numri i popullsisë në shtet ndryshon jashtëzakonisht shumë, duke pasur shtete që numërojnë me qindra deri te ato që kanë miliarda popullsi. Edhe numri popullsisë mund të ndikojë në rregullimin shtetëror – shtete me numër të madh të popullsisë që shkon në miliardë, kanë rregullim shtetëror federativ (me përjashtim të Kinës), kurse ato me numër të vogël janë shtete unitare. Popullsia e një shteti dallohet sipas cilësive racore, nacionale (etnike), fetare, sociale, ekonomike dhe cilësive të tjera. Të gjitha këto cilësi kanë rëndësi për të drejtën kushtetuese dhe reflektohen në të, qoftë kur pasqyrohen sa duhet, ashtu edhe kur shtypen (fshihen) nga normimi kushtetues. Cilësia më e lartë e popullsisë në një shtet, në aspektin juridiko-kushtetues, është shtetësia. Shtetasit janë juridikisht në tërësi të lidhur për shtetin përmes shtetësisë: kanë të gjitha të drejtat dhe detyrimet, për dallim nga të huajt, të drejtat e të cilëve në shtete të huaj nuk janë të plota sepse nuk gëzojnë të gjitha të drejtat dhe nuk kanë krejt detyrimet e plota që kanë shtetasit.

Elementi i tretë i shtetit është **pushteti**, i cili në territorin shtetëror është urdhërdhënësi suprem ndaj popullsisë dhe ka monopolin e dhunës fizike. Bëhet fjalë, pra, për pushtetin më të lartë në vend - pushtetin shtetëror. Në vendet demokratike, pushteti duhet të jetë i pranuar nga shumica e qytetarëve, për të qenë legjitim. Pushteti shtetëror rregullon të gjitha marrëdhëniet shoqërore në mënyrë gjithëpërfshirëse, është i pavarur dhe mëvetësishëm, unik (ani pse ndahet në funksione të ndryshme, më kryesore nga të cilat janë ligjvënia, ekzekutivi dhe gjyqësori, si dhe pushtetet tjera neutrale të agjencive dhe institucioneve të pavarura dhe autonome) dhe i vazhdueshëm (zgjat ani se ndryshojnë bartësit e tij). Pushteti shtetëror është sovran, që do të thotë se është autoriteti më i lartë në shtet (**summa potestas**). Kjo cilësi e bënë vetë shtetin sovran të pavarur kundrejt shteteve dhe subjekteve të tjerë të së drejtës ndërkombëtare dhe pa asnjë kufizim juridik për miratimin e akteve juridike. Origjina e pushtetit shtetëror gjenden në popull, përkatësisht qytetarë (dikur kjo origjinë ka qenë në Zot apo në sundimtarë), të cilët e bartin sovranitetin e tyre në pushtet shtetëror përmes zgjedhjes së organeve të tij.

Cilësia e pushtetit shtetëror sipas së cilës ai është autoriteti më i lartë, nënkupton se në shtet ekzistojnë edhe autoritete të tjera: në vetëqeverisjen lokale, në ndërmarrje, në familje, por ato nuk janë autoriteti më i lartë në vend. Në teori dhe në praktikë ekzistojnë vende që kanë territor dhe popullsi, por nuk janë sovrane, për shkak se pushteti që ushtrojnë nuk është krejtësisht i pavarur dhe i mëvetësishëm. Kjo nënkupton se elementi i pushtetit shtetëror, për të qenë valid duhet të jetë politikisht dhe juridikisht **legjitim.**

Në vendet demokratike, pushteti shtetëror për të qenë i vlefshëm duhet të jetë **legjitim**. Si i tillë, në aspektin juridiko-kushtetues dhe politik konsiderohet ai pushtet që gëzon besimin e qytetarëve, të cilët pranojnë institucionet e tij (parlamentin, qeverinë, gjykatat). Për dallim nga shtetet e hershme, në të cilat legjitimiteti ka rrjedhur nga Zoti (teoria teokratike) apo nga vetë shteti si i tillë (teoria autokratike), në shtete demokratike legjitimiteti i pushtetit shtetëror rrjedh nga qytetarët dhe autoriteti i tij është prodhim i sovranitetit popullor. Pushteti legjitim është shenjë e shtetit stabil ligjor. Për dallim nga **legjitimiteti**, që nuk është vetëm një nocion vetëm politik por edhe politik e sociologjik, **legaliteti** është koncept tërësisht juridik. Pushtet legal quhet ai pushtet që është formuar në mënyrë të ligjshme dhe puna e të cilit, përkatësisht aktiviteti i funksionarëve shtetërorë bazohet në ligj.

Këto si më sipër janë **elemente konstituive të shtetit**, pa të cilat shteti nuk ekziston dhe nuk mund të cilësohet si shtet. Përveç këtyre, shteti posedon edhe disa cilësi të tjera që nuk kanë karakter konstituiv, siç janë **simbolet shtetërore**. Me to ruhet veçantia e kombit dhe shtetit kundrejt të tjerëve. Në mesin e simboleve, më të rëndësishmit janë: stema shtetërore, flamuri dhe himni. Stema është shenjë unike heraldike që simbolizon shtetin-traditën, veçoritë dhe popullin e tij. Flamuri shtetëror është shenjë karakteristike e shtetit dhe identitetit të tij; përbëhet nga ose disa ngjyra, me ose pa shenja në të (zakonisht si shenjë shërben stema shtetërore). Himni shtetëror zakonisht është një melodi patriotike, që ekzekutohet në rastet zyrtare dhe solemn, me ose pa tekst. Me himnin shtetëror, në mënyrë simbolike shprehet veçantia nacionale, politike, ideologjike dhe kulturore e kombit dhe pavarësia e shtetit.

Shtetet mund të **ndahen** sipas kritereve të ndryshme: antropologjike dhe etnologjike (popullsia), ekonomike (pasuria), gjeografike (sipërfaqja dhe relievi). Kriteret tona, ndërkaq, janë të karakterit **juridiko-kushtetues**, krejtësisht të ndryshme nga secili prej kritereve si më sipër. Si kritere bazë të natyrës juridiko-kushtetuese janë:

- **forma e rregullimit shtetëror;**
- **forma e pushtetit shtetëror; dhe, së fundi,**
- **forma e qeverisjes/sundimit.**

Sipas formës së rregullimit shtetëror, shtetet ndahen në **shtete të përbëra**, **shtete të thjeshta/unitare.** Këto forma përcaktohen sipas asaj nëse në shtet ekziston një organizatë shtetërore apo disa sosh, si dhe lidhjet që ekzistojnë në mes tyre. Në llojin e parë, thënë ndryshe, ekzistojnë bashkësi të dallueshme juridiko-politike që kanë organet e tyre të pushtetit, kurse në të dytin nuk ekzistojnë organe të tilla.

Shteti i përbërë është ajo bashkësi politike që në gjirin e saj ngërthen disa organizata shtetërore. Në disa raste, ato organizata shtetërore formojnë rendin e përbashkët kushtetues, krahas rendeve të tyre kushtetuese (federata), kurse në të tjerat, rendet kushtetuese kanë jetë të ndarë dhe tërësisht të pavarur me rendin kushtetues të subjektit që cilësohet si shtet i përbërë (bashkësitë apo unionet e shteteve sovrane dhe të pavarura). E thënë me fjalë të tjera, të llojit të parë janë **shtetet federale**, kurse të dytit janë **konfederata, unionet reale** dhe **personale.** Në aspektin e të drejtës ndërkombëtare, shtetet e llojit të dytë përfaqësojnë një grupim të shteteve që, pa formuar një shtet të ri, formojnë një grupim të ri që qartësisht dallohet në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, dallim që rezulton nga lidhja e vërtetë institucionale që formohet në mes të anëtarëve të shtetit të përbërë (konfederatës, unionit real dhe unionit personal). Në aspektin e të drejtës kushtetuese, ndërkaq, shteti i përbërë që nuk është shtet federativ ka për cilësi themelore pasjen e disa organeve të kufizuara dhe të pjesshme të përbashkëta, përkatësisht pasjen e një forme të kufizuar dhe të pjesshme të mekanizmave institucionalë.[425]
Përveç këtyre dy llojeve të zakonshme të **shteteve të përbëra**, përkatësisht federatës, konfederatës, unioneve personale dhe reale, ekzistojnë edhe forma të tjera të lidhjeve juridike-shtetërore që prodhojnë

[425] Marcel Prélot, Jean Boulouis, *Institutions politiques et droit constitutionnel*. 11e éd. édition (Précis Dalloz: Paris, 1990) fq. 299-289.

kategori të posaçme të identiteteve shtetërore, si në planin ndërkombëtar ashtu edhe në atë kushtetues. Ato përmblidhen në dy grupime: e para, lidhjet e pabarabarta shtetërore; dhe, e dyta, lidhjet fleksibël (të çliruara) shtetërore. Në grupin e parë hyjnë **shtetet vasale**, **shtetet nën protektorat**, **shtetet nën mandat** dhe, së fundi, **shtetet nën kujdestari**. Në grupin e dytë, ndërkaq, mund të futen **komonveltet** dhe lidhjet tjera të metropolës me ish-kolonitë (lidhja franceze me vendet frankofone të Afrikës perëndimore, lidhja ruse me vendet e ish-**BRSS** etj.).[426]

Shtetet e thjeshta/**unitare** nuk kanë brenda tyre bashkësi juridiko-politike që ngjasojnë me shtetet sovrane dhe të pavarura, sepse pushtetin shtetëror e ushtrojnë organet qendrore të pushtetit si organe të vetme shtetërore. Në shtetin unitar ekziston një bartës unik i pushtetit shtetëror. Në territorin shtetëror të shtetit unitar nuk ekziston një organizatë tjetër shtetërore e llojit të njëjtë, që do të konkurronte me të në ushtrimin e pushtetit shtetëror ndaj popullsisë së njëjtë. E thënë me fjalë të tjera, shteti unitar ndahet në njësi territoriale që nuk janë shtete apo nuk kanë karakteristikat e shtetit. Këto lloje të shteteve mund të jenë të **centralizuara**, kur pushteti është në një vend, dhe të **decentralizuara**, në të cilat pushteti ushtrohet edhe jashtë qendrës, nëpër nivele më të ulëta. Instrumenti përmes të cilit arrihet nënshtrimi i plotë i organeve joqendrore nga organet qendrore dhe ndërtohet rregullimi shtetëror i centralizuar në shtetin unitar quhet **dekoncentrim** i pushtetit, kurse instrumenti me ndihmën e të cilit organeve joqendrore iu lejohet një shkallë e caktuar e pavarësisë në raport me organet qendrore dhe ndërtohet rregullimi shtetëror i decentralizuar quhet **decentralizim**. Dekoncentrimi dhe decentralizimi janë dy modalitete të realizimit të parimit të unitetit të vullnetit shtetëror në shtetin unitar. **Decentralizimi i pushtetit** mund të jetë **funksional** (njohja e një shkalle të pavarësisë shërbimeve publike ose shërbimeve në interes të përgjithshëm, për të cilat përkujdeset shteti, që konsiston në pjesëmarrjen e tyre në drejtimin dhe udhëheqjen e vetvetes) dhe **territorial** (nënkupton pavarësinë me të cilën disponojnë entitetet, përkatësisht qytetarët që jetojnë në to, që brenda ligjit të udhëheqin me vetveten në sferën e punëve lokale). Ky është kuptimi i gjerë i decentralizimit territorial dhe paraqet vetëqeverisje popullore, e cila, në vartësi të madhësisë së territorit, mund të jetë **vetëqeverisje lokale** (në bashkësitë lokale) dhe **autonomi regjionale territoriale** (në bashkësi apo regjione të mëdha). Këtu nuk bëhet fjalë për bartjen e punëve të caktuara shtetërore për kryerje te organet e themeluara nga shteti, si te rasti i dekoncentrimit, veç për kryerjen në mënyrë vetëqeverisëse të punëve lokale dhe regjionale, si punë vetjake (punë origjinere dhe që nuk janë të bartura). Vetëqeverisja lokale dhe autonomia territoriale janë forma të decentralizimit në kuptimin e gjerë të shtetit unitar (si shtet i thjeshtë, jofederal). Për dallim nga format e decentralizimit në kuptim të ngushtë, si decentralizim i administratës shtetërore, që mësohet në të drejtën administrative, vetëqeverisja lokale dhe autonomia territoriale, si forma të decentralizimit të gjerë, mësohen dhe shtjellohen në të drejtën kushtetuese.

Sipas **formës së pushtetit shtetëror** ekzistojnë shtete në të cilat sistemi i pushtetit është i bazuar në **parimin e ndarjes së pushtetit** dhe shtete ku sistemi bazohet në **parimin e unitetit të pushtetit**. Parimi i ndarjes së pushtetit qëndron në themel të shteteve që kanë sistem parlamentar, presidencial dhe gjysmëpresidencial, kurse mbi parimin e unitetit të pushtetit ndërtohen sistemet e kuvendeve, si demokratike dhe autoritare (jo demokratike).

Sipas formës së **qeverisjes/sundimit** shtetet ndahen në **republika**, që kanë në krye të tyre presidentin, dhe në **monarki**, në krye të të cilave qëndron kurora që është e trashëgueshme (perandori, mbreti, princi, duka etj.). Si kriter për dallim këtu shërben, pra, mënyra e organizimit të zyrës së shefit të shtetit, roli dhe pozita e tij kushtetuese.

[426] Marcel Prélot, Jean Boulouis, *Institutions politiques et droit constitutionnel*. 11e éd. édition (Précis Dalloz: Paris, 1990), 289-301.

9.2. Parimet themelore të konstitucionalizmit modern

Konstitucionalizmi modern shënon periudhën që fillon me miratimin e kushtetutave të para në kuptimin formal, në fund të shek. XVIII dhe në shek. XIX. Është më e hershme, megjithatë, ideja mbi aktet juridiko-politike me të cilat rregullohet organizimi dhe ushtrimi i pushtetit sesa liritë dhe të drejtat e njeriut. Në këtë kuptim kanë ekzistuar përvoja qysh në Greqinë e vjetër, Romë dhe Mesjetë.

Në Greqinë e vjetër është bërë dallim në mes të konceptit **politeia** dhe rregullave të njohura si **nomos**: në konceptin e parë janë përfshirë tërësinë e rregullave mbi të cilat është bazuar rregullimi shtetëror dhe rendi shoqëror, kurse me të dytin rregullat që kanë përpunuar institucionet dhe parimet që janë krijuar me rregullativën e konceptit të parë. Edhe romakët kanë bërë dallim në mes të dy pushteteve më të larta: i pari ka qenë pushteti që krijon shtetin ("rem publicum constituere") dhe i dyti pushteti që sjell ligje ("legel scribere"). Sikundër u tha më sipër, vetë fjala moderne kushtetutë (**constitutio**) ka lindur në Romë.

Kjo ka vlejtur edhe për Mesjetën, ani pse fjala kushtetutë ka vazhduar të përdoret, por me kuptime të ndryshme. Në Angli, gjatë sundimit të **Henrit II** (Henry II of England: 1133-1189), fjala kushtetutë është përdorur për ligjet me rëndësi dhe me vlerë të posaçme. I tillë ka qenë, ta zëmë, rasti i sipërcekur i **Kushtetutës së Klarendonit** të vitit 1164 dhe i krejt akteve me rëndësi kushtetuese që u shtjelluan në seksionet 2.1 dhe 3.1 **supra**.

Në këtë kohë, u mor vesh, sikundër u tha, shtetet nuk kanë pasur kushtetuta në kuptimin e sotëm të fjalës, por vetëm disa akte juridiko-politike që kanë rregulluar pjesë të caktuara të materies kushtetuese. Për lindjen e kushtetutave si akte të tërësishme, që njëkohësisht kanë karakter ideologjiko-politik dhe shërbejnë si dispozita me fuqi më të madhe juridike, ka pasur nevojë për një përgatitje teoriko-filozofike të materies kushtetuese, shqyrtim juridik dhe politologjik i saj, i shoqëruar me një zhvillim të përgjithshëm civilizues. Në këtë kuptim, vendimtar janë trajtimet dhe shtjellimet e shekujve XVII-XVIII **Xhon Lloku**, **Zhan Zhak Ruso**, **Abati Sijes**, me herët **Tomas Hobsi** (Thomas Hobbes: 1588-1679), **Baruh de Spinoza** (Baruch de Spinoza: 1632-1677) dhe **Rene Dekart** (René Descartes: 1596-1650), hodhën idetë se kushtetuta është shprehje e marrëveshjes shoqërore, të cilën e lidhin qytetarët me qëllim të krijimit të pushtetit tokësor, të përbotshëm dhe johyjnor. Këtij pushteti të krijuar në këtë mënyrë, qytetarët i nënshtrohen me vullnet. Pasojë e lidhjes së marrëveshjes shoqërore është që sistemi juridik që krijon shteti, detyron çdokënd. Nga teoria mbi **kontratën shoqërore**, e cila, u mor vesh, është pikëpamje metafizike dhe fiksion teorik, sepse qytetarët asnjëherë nuk lidhin marrëveshje apo kontratë me secilin dhe me krejt së bashku, ka lindur teori juridiko-kushtetuese dhe konstitucionalizmi modern. Kushtetutat e para të shkruara në dy anët e **Atlantikut** (SHBA dhe Francë) kanë qenë të frymëzuara fuqishëm nga idetë mbi ndarjen e pushtetit që e kanë përpunuar **Monteskie** (Charles Louis de Secondat, Baron de La Brède et de Montesquieu: 1689-1755) dhe **Xhon Lloku**. I pari konsiderohet si themelues i parimit kushtetues mbi ndarjen e pushtetit, i cili ka përshkruar dhe teorikisht e ka formësuar sistemin e pushtetit që veç kishte ekzistuar në Angli, ku pushteti ekzekutiv dhe ligjvënës kontrollonin dhe kufizonin njëri- tjetrin në mënyrë reciproke.

Konstitucionalizmi modern ka lindur nga **ideologjia e liberalizmit**, së cilës në mënyrë graduale iu janë shtuar idetë social-demokratike mbi kushtetutat më të mira të punës dhe sigurimin social. Për këtë arsye cilësohet si konstitucionalizëm liberal dhe liberal-demokratik dhe ka disa parime mbi të cilat janë ndërtuar shtete demokratike sot. Ato janë:

- demokracia dhe sundimi i ligjit;
- epërsia e lirive dhe të drejtave të njeriut;
- sovraniteti;
- legaliteti dhe legjitimiteti i pushtetit shtetëror;
- e drejta për rezistencë dhe ndërrimin e bartësve të pushtetit; dhe,
- kufizimi dhe kontrolli.

Të gjitha këto parime ndërtojnë demokracinë, qeverisjen demokratike. Këto parime të konstitucionalizmit modern nuk vlejnë në plotësi në llojet tjera të tij. Kështu, ta zëmë, në **konstitucionalizmin socialist** (aktualisht i zbatueshëm në Kinë, Kore e Veriut, Kubë, Vietnam etj., dikur në ish-vendet komuniste të **Evropës**) nuk ekziston sundimi i ligjit, që nënkupton mbi të gjitha liri politike dhe sistem pluralist politik (shumëpartiak). Në vend të kufizimit të pushtetit përmes ndarjes dhe baraspeshës së tij, në konstitucionalizmin socialist ekziston **parimi i unitetit të pushtetit**, me kuvendin politikisht monolit si organ kryesor. Përveç kësaj, kufizimi i pushtetit përmes garancioneve kushtetuese mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, standard ky i demokracive liberale perëndimore, ka një domethënie tjetër. Mjafton të përmend këtu tri postulate perëndimore: jeta, liria dhe prona. Në rastin e lirisë, ajo formalisht garantohet me kushtetutat e vendeve socialiste, por kufizimet drastike më pastaj përcaktohen me ligj, duke iu dhënë autorizime organeve represive për cenimin e lirisë në rastet kur interesat e socializmit vihen në pyetje, koncept ky abstrakt dhe tërësisht dubioz. E njëjta vlen edhe për jetën, e cila garantohet me kushtetutë, Përveç rasteve kur një gjë ndryshe përcaktohet me ligj, duke sanksionuar kësisoj dënimin me vdekje për vepra të caktuara penale, në veçanti ato që rrënojnë themelet e rendit kushtetues dhe ligjshmërisë socialiste. Së fundi, pacenueshmëria e pronës, si një garancion kushtetues, zbutet deri në atë masë sa minimizohet dukshëm duke prishur vetë substancën e kësaj të drejte të shenjtë në kulturën perëndimore. E thënë me fjalë të tjera, në ndërkohë që pranohen disa garancione kushtetuese formalisht, cungimi i tyre me ligje të zakonshme përbën një standard në botën e konstitucionalizmit socialist. Kjo efektivisht nënkupton epërsi (supremaci) të ligjit, jokushtetutës.

9.2.1. Demokracia dhe sundimi i ligjit

Demokracia, nga fjalët greke **demos**-populli dhe **kratos**-pushteti apo qeverisja, paraqet, thjeshtë, regjim politik ku qeveris populli, përkatësisht nga populli pushteti i zgjedhur. Kjo është e kundërt me autokracinë, regjim ku ekziston pushteti i pakufizuar i një individi ose pakice. Vetëm koncepti, ndërkaq, ka pasur kuptime të ndryshme teorike dhe zbatime të ndryshme në praktikë, gjë që e ka bërë kundërthënës, të papërcaktuar dhe të përshtatshëm për shpërdorime politike. E, megjithatë, si e ka thënë **Uinston Çërqill** (Sir Winston Leonard Spencer-Churchill: 1874-1965), demokracia ngelet forma më e keqe e qeverisjes, nëse përjashtojmë të tjerat.[427] Kjo është kështu si pasojë e shumë faktorëve: interpretimeve të ndryshme të nocionit të demokracisë, mungesa e kritereve të përbashkëta (standarde) teorike për përcaktimin e elementeve të demokracisë dhe, së fundi, shpallja e çdo rregullimi të ri shtetëror model të ri të demokracisë. Përkundër këtyre dilemave, mund të thuhet se elementi më i rëndësishëm i qeverisjes demokratike është realizimi i vullnetit politik të popullit, përkatësisht shumicës së qytetarëve.

Sundimi i ligjit, apo thënë më saktë: sundimi i së drejtës, është sistemi në të cilin pushteti qeverisë dhe drejton me ndihmën e normave të krijuara paraprakisht. E drejta është një mjet i pushtetit, por, në të njëjtën kohë, edhe pushteti është i kufizuar nga e drejta. Gjendja e sundimit të së drejtës në një shoqëri ekziston atëherë kur sistemi juridik përbëhet nga aktet e prodhuara ligjërisht (pikëpamja pozitivo-juridike, që fokusohet në ligjshmërinë e miratimit të akteve juridike). Ky ndryshe quhet dhe botëkuptimi formal i sundimit të së drejtës apo **koncepti i hollë** i këtij kuptimi ("thin concept"). Këtu anashkalohet dhe shpërfillet përmbajtja e sistemit juridik, cilësia e normave dhe parimeve të tij. Në këtë kuptim, gati për çdo shtet mund të pohohet se është i bazuar në sundimin e së drejtës, nisur nga fakti se sadopak posedon një sistem të normave të vlefshme. Botëkuptim tjetër është ai që niset nga vlerësimi se sundimi i së drejtës ekziston jo vetëm kur shteti posedon një sistem të vlefshëm të normave juridike, të miratuara në rrugë ligjërisht të vlefshme, por edhe kur ato akte dhe krejt sistemi si tërësi kanë cilësi apo kualitetet të caktuara (pikëpamja materialo-juridike, që fokusohet,

[427] **Winston S Churchill, 11 November 1947**. *INTERNATIONAL CHURCHIL SOCIETY.* Në internet: https://winstonchurchill.org/resources/quotes/the-worst-form-of-government/ (shikuar në mars 2022).

krahas në ligjshmërinë e procesit të prodhimit të akteve juridike, edhe në kualitetin apo cilësinë e tyre të brendshme). Këto cilësi në rend të parë kanë të bëjnë me vlerat që mbrojnë aktet juridike të sistemit juridik, të prodhuara në procedurë ligjërisht të duhur. Për këtë arsye, kjo pikëpamje quhet dhe kuptimi material i sundimit të së drejtës, apo **koncepti i trashë** i sundimit të së drejtës ("thick concept").[428]

I kuptuar kësisoj, sundimi i së drejtës mund të mbrojë vlera të ndryshme, në vartësi të përmbajtjes ideologjike. Kështu, ta zëmë, **versioni liberal-demokratik i sundimit të së drejtës** nënkupton dhe mbron ekonominë e lirë të tregut, sistemin shumëpartiak, botëkuptimin liberal mbi liritë dhe të drejtat e njeriut (epërsia e lirive dhe të drejtave personale dhe politike ndaj lirive dhe të drejtave sociale, ekonomike dhe kulturore). Në anën tjetër, **versioni socialist i sundimit të së drejtës** përfshinë ekonominë e dirigjuar si vlerë që mbrohet, sistemin njëpartiak, epërsinë e të drejtave kolektive ndaj lirive dhe të drejtave individuale. Si një version i konceptit të trashë të sundimit të së drejtës llogariten nga disa autorë edhe modelet e sundimit të së drejtës që bazohen në "vlerat aziatike", që cilësohen si "autoritare por të buta", dhe gjenden në sistemet politike dhe ekonomike të vendeve aziatike. Këtu në rend të parë mendohet për sundimin e së drejtës "me karakteristika kineze" dhe shërben si një version alternativ i modelit perëndimor të konceptit të trashë të sundimit të ligjit[429] U mor vesh, kjo qasje nuk mund të pranohet sepse bëhet fjalë për deformim të idesë dhe praktikës së sundimit të së drejtës që bazohet në vlerat që trajtohen në vijim të këtij seksioni, në rend të parë në parimin e ndarjes dhe balancimit të pushtetit dhe mbrojtjes dhe promovimit të lirive dhe të drejtave të njeriut (atyre personale dhe politike në rend të parë). Nuk mund të ketë "vlera aziatike" ose "vlera evropiane" në vetvete që sigurojnë dhe promovojnë sundimin e së drejtës, por koncepte e praktika konkrete që bazohen në liri e të drejta njerëzore që shërbejnë si kufizues efektiv i pushtetit politik.

Koncept i lidhur ngushtë me sundimin e së drejtës është shteti i së drejtës, si një botëkuptim i konstitucionalizmit modern, që ekziston atëherë kur në shtet respektohen dhe mbrohen liritë dhe të drejtat e njeriut, epërsia e ligjit prevalon si standard për kufizimin e pushtetit. Përkundër që, në aspektin historik dhe institucional, shteti dhe sundimi i së drejtës janë dy koncepte të ndryshme (i dyti është anglo-sakson kurse i pari ka origjinë gjermane), sot ato barazohen sepse edhe njëri edhe tjetri janë kuptime formalo-materiale që kanë idenë e njëjtë themelore-kufizimin e pushtetit shtetëror. Dallimet kanë ekzistuar sepse shteti i së drejtës, për shkak të ndikimit të pozitivizmit (në veçanti të pozitivizmit të promovuar nga **Hans Kelsen**), është trajtuar vetëm si parim formal, në formën e parimit të legalitetit (ligjshmërisë) të thjeshtë dhe pa përmbajtje (kjo në veçanti gjen shprehje në literaturën anglo-amerikane), kurse sundimi i së drejtës si një kuptim material, parim më i lartë se edhe vetë kushtetutshmëria, sepse tregon përmbajtjen e kushtetutës, përkatësisht vlerat që mbron kushtetuta. Këtë pikëpamje e ka mbrojtur Fridih Hajek (Friedrich August von Hayek: 1899-1992).

9.2.2. Liria dhe epërsia e të drejtave të njeriut

Në kuptimin më të gjerë, liria (lat: "libertas") është gjendja në të cilën njeriu është i lirë, vepron pa asnjë shtrëngim e dhunë. E kundërt me një gjendje të tillë të njeriut është skllavëria. Liria që shërben si pikënisje e konstitucionalizmit modern, megjithatë, nuk mund të jetë absolute sepse një liri e tillë e një njeriu, do të nënkuptonte joliri për anëtarët tjerë të shoqërisë së organizuar në shtet. Për këtë arsye, kushtetuta dhe pushteti shtetëror që e vë në jetë kanë për detyrë të garantojnë lirinë për të gjithë dhe të mbrojnë lirinë e çdokujt.

---

428 Jane Stromseth, David Wippman, Rosa Brooks, *Can Might Make Rights?: Building the Rule of Law after Military Interventions.* First Edition (Cambridge University Press: Cambridge, 2006), fq. 68-77.

429 Cf. më shumë në përmbledhje e pikëpamjeve të këtij lloji në Randall Peerenboom (ed*.), Asian Discourses of Rule of Law, Theories and Implementation of Rule of Law in Twelve Asian Countries, France and the US (*Routledge Curzon: London, New York, 2004).

Konstitucionalizmit **liberal** dhe **liberalo-demokratik** nuk e shohin lirinë njëtrajtshëm. Konstitucionalizmi liberal (kushtetutat e para të shkruara) i jep përparësi **kuptimit negativ** të lirisë, "liria nga", që në të vërtetë është liri nga pushteti shtetëror, dhe përfshinë zonën private të individit. Qëllim i këtij konstitucionalizmi ka qenë që nga pushteti, dikur absolut, të merret sa më shumë, të përfitohet nga ai sa më shumë pushtet dhe të kthehet në liri të paprekshme të individit. Konstitucionalizmit liberal-demokratik (nga revolucionet e viteve 1848-1849) nuk është vetëm "liri nga" por edhe "liri për". Në këtë mënyrë liria bëhet edhe koncept juridiko-kushtetues pozitiv, me individ aktiv, jo vetëm të mbrojtur, që përmes të drejtave zgjedhore dhe të drejtave të tjera politike ndikon në pushtet.

Përkundër sferës në të cilën vepron shteti, sferës së "lirisë nga" dhe "lirisë për", është krijuar edhe fusha e **shoqërisë civile**, në veçanti në dekadat e fundit të shekullit XX. Kjo shprehje është farkëtuar nga **Xhon Llok**, si "civil society", që duhet të kontrollojë pushtetin që i përgjigjet qytetarëve. Ajo përbëhet nga subjekte të ndryshme-sektori joqeveritar, shoqata e individë që synojnë të ndikojnë në pushtet dhe opinionin publik. Shoqëria civile me pushtetin praktikisht merr pjesën në krijimin dhe zbatimin e ligjeve për këtë plotësohen kushtet e caktuara: realizohet sundimi i së drejtës, sigurohen liritë dhe të drejtat e njeriut, funksionet publike janë të qasshme, tregu është i lirë, kultura politike është e zhvilluar.

Konstitucionalizmi modern nënkupton **epërsinë e lirive dhe të drejtave të njeriut**. Liritë dhe të drejtat e njeriut gëzojnë garancione dhe mbrojtje kushtetuese dhe përcaktojnë kufijtë e organeve të pushtetit. Të drejtat më të rëndësishme të njeriut janë më të vjetra se pushteti, siç janë "të vërtetat e dukshme" dhe të drejtat natyrore: jeta, liria, barazia. Këto janë jashtë caqeve të pushtetit politik dhe i mbron pushteti gjyqësor, përfshirë gjyqësinë kushtetuese. Mbrojtja e tyre mund të konsiderohet si qëllim i ekzistencës dhe detyra më e rëndësishme e shtetit, siç ka thënë **Xhames Madison**. Dikur ka mbizotëruar bota në të cilën "njeriu për njeriun ka qenë ujk", shprehje e përdorur nga Tomas Hobs për të përshkruar gjendjen natyre të njeriut, dhe kjo ka ngritur nevojën për ndërtimin e një pushteti sipëror, më të fuqishëm se individët, që të mbronte të drejtat dhe liritë e individit dhe të gjithë të gëzonin të njëjtat liri dhe të drejta. Me kohë, nga ky pushtet që mbron liritë dhe të drejta e individit është kërkuar që të jetë legjitim, që të ketë përkrahjen politike të qytetarëve. Në ndërkohë që idetë e Hobsit dhe të tjerëve mbi gjendjen natyrore, kanë qenë ndërtime fiktive teorike, që mund të mos kenë ekzistuar asnjëherë në të kaluar, por kanë shërbyer për të arsyetuar teorinë e tyre të kontratës sociale, idetë dhe praktika e legjitimitetit politik ka qenë më e prekshme dhe nis me luftën e borgjezisë liberale për ndryshim të origjinës hyjnore të pushtetit (fundi i shek. XVIII e tutje).

9.2.3. Sovraniteti, legaliteti dhe legjitimiteti

Pushteti duhet të jetë sovran, legal dhe legjitim. Si koncept juridik-kushtetues, sovraniteti buron nga krahasimi i pushtetit shtetëror me pushtetin që kanë institucionet dhe subjektet tjera në përgjithësi: sovran është pushteti më i lartë, suprem, dhe ai është pushteti shtetëror që ka epërsi ndaj krejt pushteteve dhe subjekteve të tjerë. Pas këtij pushteti sovran qëndron fuqia më e lartë e mundshme, që është garant i saj.

Në shtetet demokratike, sovraniteti buron nga qytetarët dhe quhet sovranitet popullor. Sipas këtij standardi, qytetarët bartin pushtetin e tyre sovran në shtet përmes zgjedhjeve, njëkohësisht duke ruajtur të drejtën për të ushtruar atë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kjo përbën esencën e **sovraniteti popullor**, si tërësi e sovraniteteve individuale të individëve, që dallon dukshëm nga **sovraniteti i kombit**, që i vishet tërë popullit-bashkimit të krejt qytetarëve. Në këtë kuptim, **kombi** është një entitet i veçantë dhe i pandashëm. Më herët, para paraqitjes së kushtetutave të para të shkruara, sovraniteti ka qenë i lidhur me sundimtarin, pushteti sovran i të cilit nuk ka mund të humbet asnjëherë, sepse ai pushtet sovran ka qenë i lidhur me personin e tij/saj dhe ka qenë përjetësisht i njohur si i tillë-si pushtet sovran i mishëruar në personin e sundimtarit (kurorës). Ky pushtet sovran është cilësuar si një e keqe më e vogël dhe më pak e dëmshme për liritë dhe të drejtat e njeriut, krahasuar me situatën kur fare nuk ekziston një pushtet i tillë. Ky ka qenë arsyetimi i hershëm i filozofëve të kontratës

sociale, në rend të parë i Tomas Hobsit, por edhe i teoricienëve të tjerë.

Sovraniteti është një nocion kompleks, në të cilin mund të dallohen tri elemente përbërëse. I pari është **elementi i jashtëm**, që nënkupton pavarësinë dhe ka të bëjë me marrëdhëniet me shtetet tjera sovrane (organizatat dhe subjektet tjerë të së drejtës ndërkombëtare nuk posedojnë cilësinë e entiteteve sovrane). I dyti është **elementi i brendshëm**, që nënkupton se ai përfaqëson fuqinë më të madhe fizike, supremacia e së cilës shtrihet brenda territorit shtetëror. I treti dhe i fundit është **elementi sintetik**, me të cilin nënkuptohet e drejta e pakufizuar i pushtetit sovran për të nxjerr norma juridike, nisur nga kushtetuta. Nga këto tri elemente, shumica e shteteve posedojnë më së shumti sovranitetin e brendshëm, në ndërkohë që vetëm shtetet më të fuqishme apo të fuqishme janë në plotësi sovrane. Kjo është arsyeja pse parimi ndërkombëtar i barazisë sovrane të shteteve është kuptim formal, jomaterial. Bazuar në këtë parim, ekziston edhe një orientim kushtetues thuajse i krejt shteteve të botës që me kushtetutë përcaktojnë modalitetet e bartjes së sovranitetit në shtete dhe organizata ndërkombëtare. Jashtë bartjes formale (kushtetuese), sovraniteti cenohet dhe barazia sovrane e shteteve së bashku me të. Për këtë arsye, kur me marrëveshje ndërkombëtare pranohet një detyrim, ai nuk quhet cenim i sovranitetit shtetëror, por pikërisht realizim i tij. Tjetër gjë është shpërputhja në marrëdhëniet e pushtetit në mes të palëve kontraktuese, që nuk mund të jetë objekt rregullimi juridik-kushtetues e as juridik-ndërkombëtar. U mor vesh, përveç rasteve kur bëhet fjalë për përdorim të forcës ose kërcënimit me forcë, me qëllim të arritjes së qëllimit në marrëdhënie kontraktuese në mes të shteteve, që hyn në grupin e cenimeve të barazisë sovrane të shteteve.

Si **pushtet legal** konsiderohet ai pushtet që është formuar ligjërisht, sipas normave juridike paraprakisht të përcaktuara, zakonisht përmes zgjedhjeve të lira dhe konkurrente. E kundërt me këtë, pushteti jolegal do të konsiderohej ai pushtet që ka uzurpuar funksionet shtetërore me dhunë-**kryengritje**, **okupim** dhe **revolucion**. Për legalitetin e pushtetit mjafton që ai të jetë i bazuar në të drejtën, në një sistem normash pozitive në fuqi në momentin e marrjes së pushtetit. Ka pasur autor që legalitetin e kanë njëjtësuar me të drejtën dhe rendin juridik si tërësi.[430] Legaliteti i pushtetit i paraprinë legjitimiteti, mirëpo kjo nuk do të thotë se dy konceptet duhet të ekzistojnë njëkohësisht: pushteti legjitim mund të bëhet jolegal dhe anasjelltas-pushteti legal mund të bëhet jolegjitim. **Pushtet legjitim** është ai pushtet që gëzon besimin dhe pëlqimin e qytetarëve që të qeverisë me ta. Si i tillë, ai është shprehje e lirisë së vërtetë dhe të qytetarëve. Për këtë arsye legjitimiteti është nocion politik sepse e qytetarët pranojnë institucionet politike, të gjitha organet e pushtetit dhe bartësit konkret të funksioneve shtetërore. Në rrethanat e zakonshme, legjitimiteti i një pushtetit bartet në tjetrin përmes zgjedhjeve, votës së lirë të qytetarit, të cilën vlerësojnë nëse pushteti është i denjë për të qeverisur me ta. Qytetarët vlerësojnë bartësit e pushtetit dhe në një moment pushteti aktual mund të humb legjitimitetin sepse bartësit e sovranitetit, me shumicë kanë vendosur që atë ta kalojnë te përfaqësuesit tjerë politikë.

9.2.4. E drejta në rezistencë, kufizimi dhe kontrollimi i pushtetit

Mospranimi i pushtetit nga ana e qytetarëve, mosdhënia e pëlqimit për të përmes votës së lirë, mishëron edhe një të drejtë tjetër që aktivizohet në rrethana të caktuara jo të zakonshme. Ajo e drejtë njihet gjerësisht si e drejta për rezistencë dhe figuron qysh në librat fetarë dhe në dokumente të antikitetit të lashtë, që i ka regjistruar qenia njerëzore.[431] Bartësit e pushtetit që kanë humbur besimin e qytetarëve duhet të ndërrohen me përfaqësues të tjerë të popullit. Ky është standard i ndër-

[430] Këtë qëndrim e mban konstitucionalisti britanik me famë botërore, Ivor Xhenings (Ivor Jennings: Sir William Ivor Jennings: 1903-1965). Cf. Sir W. Ivor Jennings, *The Law and the Constitution* (University of London Press: London, 1959).

[431] Për një trajtim të shkëlqyer të së drejtës për rezistencë, që nga kohët para-biblike e deri në ditët e sotme, cf. më shumë në Aleksandar Molnar, *RASPRAVA O DEMOKRATSKOJ USTAVNOJ DRŽAVI. 1. Pravo na otpor tiraniji* (Samizdat B92: Beograd, 2001).

tuar nga **Xhon LLloku**, gjerësisht i konstitucionalizuar në kulturën perëndimore të demokracive liberale. Rezistenca ndaj fuqisë së bartësve jolegjitimë të pushtetit shtetëror mund të bëhet edhe përmes përdorimit të dhunës fizike, që nuk është e thënë domosdo të prish rendin ekzistues kushtetues. Për më tepër, në disa kushtetuta, e drejta për rezistencë sanksionohet, duke përcaktuar qartë rrethanat e aktivizimit të kësaj të drejte. I tillë është, ta zëmë, rasti i **LTH**, i cili në nenin 20.4 përcakton se: "Të gjithë gjermanët kanë të drejtë të rezistojnë, çdo person që kërkon të prish këtë rend kushtetues, nëse nuk ka në dispozicion mjet tjetër për një gjë të tillë".[432] Në literaturë kjo cilësohet si **demokraci militante**, një shprehje që nënkupton të drejtën për përdorim të dispozitave kushtetuese për të mbrojtur qeverisjen kushtetuese kundër armiqve të brendshëm. Kjo zgjidhje kushtetuese gjermane bazohet në përvojën e hidhur të gjermanëve me **Hitlerin** gjatë Luftës së Dytë Botërore.[433]

Ndarja e pushtetit është një instrument i fuqishëm i konstitucionalizmit modern që i shërben kontrollit dhe kufizimit të pushtetit. Edhe liritë dhe të drejtat e njeriut kufizojnë pushtetin, por ndarja e tij, këtë gjë e bënë më efektive dhe në një mënyrë tjetër. Me këtë rast, tri organet e pushtetit, legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, janë të ndarë në aspektin organizativ dhe funksional, në ndërkohë që kanë bashkëpunim ndërmjet veti. Gjyqësori i pavarur, së bashku me kontrollin reciprok të pushtetit ekzekutiv dhe ligjbërës, ruajnë lirinë e qytetarëve. Në këtë mënyrë, pushteti i nënshtrohet kontrollit të popullit, që përmes përfaqësuesve të vet formon pushtetet politike, legjislativin dhe ekzekutivin, kurse gjyqësorit i garantohet pavarësia bazuar në standarde profesionale. Në të kaluarën nuk ka qenë kështu sepse sundimtari dhe pushteti i tij kanë qenë jashtë kontrollit, përfshirë edhe të drejtën që e ka krijuar vetë kurora. Sot e drejta shërben si parametër matës i sjelljes së shtetit, duke ndarë dhe baraspeshuar funksionet e shtetit në aspektin funksional, organizativo-financiar dhe në personel. Kjo ndarje dhe baraspeshimi i pushtetit cilësohet si i moderuar, kur organet e pushtetit ndërveprojnë dhe kontrollojnë reciprokisht njëri-tjetrin, dhe si i ngurtë, kur ndarja dhe baraspeshimi nuk bëhet përmes bashkëpunimit por konkurrencës.

Pikërisht për këtë arsye, për të qenë efektiv kufizimi dhe baraspeshimi i pushtetit duhet të krijohen mekanizma relevantë të kontrollit. Këta mekanizma funksionojnë në një ambient të dhënë shoqëror, ku ekziston një stabilitet institucional dhe respekti për liritë dhe të drejtat e njeriut. Vetëm në situatën kur ekzekutivi i përgjigjet parlamentit dhe gjyqësori mbron në mënyrë efikase liritë dhe të drejtat e njeriut, mund të flitet për realizim të kushtetutës liberale-demokratike. Krahas kësaj, pushteti mund të kufizohet dhe kontrollohet në mënyrë dhe nga subjektet të tjerë që formalisht nuk mbajnë postet institucionale të pushtetit: kapitali i madh, partitë politike me mënyrën e tyre të punës dhe vendimmarrjes mund ta bëjnë marrëdhënien e kontrollit në mes të parlamentit dhe ekzekutivit në një formë të thjeshtë që vihet në jetë nga oligarkia partiake. Në këto raste bëhet fjalë për të kundërtën e kufizimit dhe kontrollit të pushtetit, përkatësisht bëhet fjalë për deformim të pushtetit, përkatësisht për kontroll dhe kufizim të tij në dëm të realizimit të lirive dhe të drejtave të individit, demokracisë dhe sundimit të ligjit, duke prodhuar forma të shfytyruara të marrëdhënieve socio-politike dhe socio-ekonomike.

---

[432] Neni 20.4 ["Parimet Kushtetuese- E drejta e rezistencës"] i LTH. **Basic Law for the Federal Republic of Germany. 1949, as amended to 2019.**

[433] Cf. më shumë për këtë në Judith Wise, "Dissent and the Militant Democracy: The German Constitution and the Banning of the Free German Workers Party". *The University of Chicago Law School Roundtable* Vol. 5 Isssue 1 (1998), fq. 301-343; Patrick Macklem, "Militant democracy, legal pluralism, and the paradox of self-determination". *International Journal of Constitutional Law* Vol 4 No 3 (July 2006), fq. 488-615; Damir Velički, "Koncept "borbene demokracije "u SR Njemačkoj". *Politička misao* Vol. 58 No. 4 (2007), fq. 35–54.

10. Komente dhe pyetje

10.1. Në traditën e sistemit juridik kontinental (civil) të së drejtës kushtetuta është akt juridik dhe akt politik. Çfarë do të thotë njëri kuptim e çfarë tjetri?

10.2. E drejta kushtetuese është degë e të drejtës publike dhe pjesë e sistemit juridik të shtetit. Çka është objekt i hulumtimit dhe studimit të së drejtës kushtetuese dhe prej çfarë përbëhet e drejta kushtetuese si degë e së drejtës pozitive?

10.3. Çka përfaqëson **momenti kushtetues**?

10.4. Çka përmban **sistemi kushtetues**?

10.5. Çka quhet **rend kushtetues**?

10.6. Çdo herë kur miratohet një kushtetutë, kushtetutëbërësi ka disa shpresa e bindje që lidhen me rolin që do të luaj kushtetuta e re. Në çka koncentrohen idetë fillestare të kushtetutëbërësit me rastin e nxjerrjes së kushtetutës?

10.7. Si definim tentativ, kushtetuta mund të definohet si akti më i lartë juridik që rregullon dhe kufizon pushtetin shtetëror. Nga ky definim mund të veçohen disa elemente përbërëse të kuptimit të kushtetues. Diskutoni!

10.8. Çka nënkuptohet me **parimin e kushtetutshmërisë**?

10.9. Ekzistojnë rastet kur në vend përkohësisht ose për kohë të pacaktuar ekziston epërsia e akteve të tjera juridike, kryesisht të natyrës juridiko-ndërkombëtare, kundrejt kushtetutës së vendit. Tregoni për cilat raste bëhet fjalë?

10.10. Para se kushtetuta të merr karakteristikën themelore si instrument që i shërben kufizimit të pushtetit, është dashur të kalohet nëpër disa procese. Kjo ka qenë një zhvillim historik i gjatë. Diskutoni!

10.11. Nga e ka origjinën fjala kushtetutë dhe çfarë ka qenë gjendja e saj në Mesjetë?

10.12. Sikundër dihet, në gjuhen shqipe përdoret fjala **kushtetutë** dhe, si e tillë, është e rrënjosur në diskursin profesional dhe laik dhe përdoret për të treguar aktin më të lartë të vendit. Si nocion gjuhësor, megjithatë, nuk përputhet me fjalën latine **constitutio**: kuptimisht qëndron shumë larg prej tij. Kjo nuk ka qenë çdo herë kështu! Diskutoni!

10.13. Pse kushtetuta ka natyrë juridike?

10.14. Pse kushtetuta ka natyrë politike?

10.15. Përveç si më sipër, natyra politike e kushtetutës ngërthen në vete pikëpamje teorike dhe filozofike të teoricienëve të ndryshëm mbi shoqërinë dhe shtetin. Kjo vërehet që nga frymëzimet teorike të kushtetutave të para të fundshekullit XVIII në Amerikë dhe Francë. Çfarë do të thotë kjo?

10.16. Manifestimi i pikëpamjeve të ndryshme teorike dhe filozofike, në tekstin kushtetues marrin trajta të ndryshme, në të cilat vlerësohen të mirat shoqërore, siç janë, ta zëmë, liria, barazia, pronësia, të cilat, së bashku, bëhen vlerat më të larta të shoqërisë për faktin se sanksionohen (mbrohen) me kushtetutë, kurse vetë kushtetuta, në këtë mënyrë, fiton një cilësi të caktuar ideologjike. Këto cilësi të kushtetutës, me cilin lloj të konstitucionalizmit kanë të bëjnë?

10.17. Çfarë dallon **konstitucionalizmi liberal** me kushtetutat e vendeve ish-komuniste apo me diktaturat tjera të proveniencës së ideologjive të ekstremit të djathtë?

10.18. Në vartësi të fokusit të analizës, prodhohen tri kuptime themelore të kushtetutës. Cilat janë ato?

10.19. Në **kuptimin normativ**, kushtetuta përfshinë një tërësi të normave që kanë përmbajtje kushtetuese dhe fuqi më të lartë juridike në kuadër të akteve juridike në vend. Mund të dallohet dimensioni **material** dhe dimensioni **formal** i kuptimit **normativ** të kushtetutës. Diskutoni!

10.20. Sa i përket **materies kushtetuese**, ajo mund të grupohet në tri çështjeve të ngjashme. Cilat janë ato?

10.21. Pjesa dërmuese e shteteve kanë kushtetutë në kuptimin formal (nuk e kanë, ta zëmë,

Britania e Madhe, Zelanda e Re, Izraeli, etj.). Kushtetuat në **kuptimin formal** ka dy cilësi themelore. Cilat janë ato?

10.22. Kushtetuta e shkruar më së shpeshti është një akt juridik i kodifikuar, shumë rrallë shfaqet në disa akte juridike. Tregoni një rast kur kushtetuta nuk shpërfaqet në një akt juridik të vetëm.

10.23. Procedura e veçantë e miratimit dhe ndryshimit (amendamentimit) të kushtetutës është cilësi e kushtetutës në kuptimin formal. Çfarë do të thotë kjo?

10.24. Nga të gjitha rregullat juridike, vetëm kushtetuta përcakton për vetveten procedurën e miratimit dhe ndryshimit (amendamentimit). A është kjo deklaratë e vërtetë? Po ligji, a cakton për vetvete procedurën për miratim dhe amendamentim?

10.25. Fuqia më e lartë juridike është cilësi tjetër e kushtetutës në kuptimin formal. Çka do të thotë kjo?

10.26. Një cilësi tjetër e kuptimit të kushtetutës në **kuptimin formal** është se ajo nuk ngërthen në vetvete krejt **materien kushtetuese**, por vetëm pjesën më kryesore dhe më të rëndësishme që ka të bëjë me shtetin dhe shoqërinë e dhënë. Tregoni se çka përfshihet në këtë materie kushtetuese?

10.27. Nëse krahasojmë kuptimet e kushtetutës në kuptimin formal dhe material, gjëja e parë që bie në sy është se kuptimi i fundit i kushtetutës është shumë më i gjerë, për shkak se përfshinë tërë **materien kushtetuese**, e cila, për shkak të vëllimit të madh, nuk mund të përfshihet në një akt të vetëm të shkruar. Për këtë arsye, kushtetuta në kuptimin formal nuk e përjashton ekzistimin e kushtetutës në kuptimin material. Çfarë do të thotë kjo? A mund të ekzistojë situatë e kundërt, pra që një shtet të këtë kushtetutë në kuptimin material dhe njëkohësisht të ketë kushtetutë në kushtetutë në kuptimin formal (një tekst unik që në mënyrë maksimalisht gjithëpërfshirëse kodifikon marrëdhëniet kushtetuese)?

10.28. Ku vihet theksi te **kuptimi politik i kushtetutës** dhe kush janë përfaqësuesit e këtij koncepti? Diskutoni!

10.29. Kuptimi **sociologjik** i kushtetutës ka lindur në përpjekjet për të sqaruar shpërputhjen në mes të anës normative dhe reale të kushtetutës së shkruar. Në çka vihet fokusi te ky kuptim i kushtetutës dhe kush është përfaqësuesi kryesor i tij?

10.30. Formën më radikale të **kuptimit sociologjik të kushtetutës** e ka përfaqësuar **F. Lasal**, i cili edhe është ndërtues i këtij kuptimi. Diskutoni!

10.31. Ai pushtet që krijon kushtetutën e parë, **grundnormën**, është pushtet konstituiv origjiner dhe nuk është i lidhur për asnjë kufizim juridik. Pse kjo është kështu? Diskutoni!

10.32. Çka është **grundnorma** për **Hans Kelsen** e çka për **Karl Shmit**?

10.33. Nga kush ushtrohet pushteti konstituiv? A mund të ushtrohet ai përveç nga populli edhe nga dikush tjetër? Tregoni në veçanti çfarë do të thotë shprehja "shumësi" në këtë kontekst?

10.34. Asnjë shqyrtim mbi kushtetutën, lindjen, kuptimin dhe zhvillimin e saj, nuk do të ishte i kompletuar pa kuptimin siç duhet të kategorisë juridiko-kushtetuese dhe politiko-filozofike të njohur si **pushtet konstituiv**. Në literaturën krahasimore të së drejtës kushtetuese më shumë njihet me shprehjen franceze **pouvoir constituant**. Në gjuhën shqipe aktualisht përkthehet si pushtet kushtetutëbërës. Pse kjo është kështu në gjuhën shqipe?

10.35. Në teorinë dhe praktikën kushtetuese, fenomeni shoqëror tanimë i njohur si **pouvoir constituant**, është shumë i komplikuar, aq shumë sa krahasohet me procesin e lindjes së universit, të planetit tokë dhe njeriut bashkë me te, si një **big bang** juridik-kushtetues. Çfarë do të thotë kjo? Diskutoni, në veçanti duke u fokusuar në autorët kryesorë që kanë operuar me këtë shprehje.

10.36. Një kohë të gjatë e drejta kushtetuese, si degë e së drejtës pozitive, është cilësuar si "E drejtë shtetërore". Pse?

10.37. Diskutoni zhvillimin e konstitucionalizmit sipas fazave të paraqitjes së tij!

10.38. Diskutoni përsiatjet teorike të dijetarëve shqiptar lidhur me konstitucionalizmin, duke shtjelluar edhe aktet e **Lidhjes së Prizrenit** dhe natyrën e tyre juridike!

10.39. Me shpalljen e pavarësisë së **Shqipërisë**, vjen deri te realizimi i konstitucionalizmit në botën shqiptare, por vetëm parcialisht, për shkak të shtrirjes së tij gjeografike: pjesa tjetër e trojeve shqiptare kishte ngelur nën sundimin e huaj, e privuar nga statusi i subjektit kushtetues dhe vetë e drejta për ekzistencë. Diskutoni!

10.40. Grekët kanë shpallur pavarësinë e tyre më 15 janar 1822, duke krijuara kështu **grundnormën** e parë të një shteti që do të modelohet sipas standardeve të konstitucionalizmit modern të kohës, bazuar në sovranitetin e popullit. Kjo pavarësi u njoh me **Protokollin e Londrës** të 3 shkurtit 1830, që njohu **Greqinë** si shtet sovran dhe të pavarur. Tri kushtetutat e para greke u draftuan në vazhdën e Luftës Greke për Pavarësi: më 1822, 1833 dhe 1827. Diskutoni!

10.41. Vënia në spikamë e religjionit grek ortodoks ngeli e rrënjosur në secilën prej kushtetutave helene deri në ditët e sotme. Kjo gjendje më së shumti erdhi në pah në mes të dy luftërave botërore: ata që ishin shqiptarë etnikë, me vendndodhje kompakte, siç ishte rajoni i Çamërisë, me nenin 2 të **Marrëveshjen e Lozanës** të 30 janarit 1923, u konsideruan thjeshtë si myslimanë. Kjo vlente edhe për popullsinë etnike turke dhe tjetër që nuk ishte e krishterë, përveç hebrenjve që u njohën si kombësi minoritare e posaçme. Kjo gjendje uniformiteti etnik dhe fetar që u imponua, u reflektua edhe në legjislacionin dhe kushtetutat greke të kohës. Diskutoni këtë gjerësisht, duke treguar pse kjo është kështu!

10.42. Sikundër u tha më sipër, **grundnorma** e parë e botës shqiptare në kuptim të parametrave të konstitucionalizmit bashkëkohor lind vetëm më datën 28 nëntor 1912, kur në Vlorë shqiptarët shprehin vullnetin e tyre politik për formën dhe përmbajtjen e ekzistencës politike, si një shtet sovran dhe i pavarur. Diskutoni!

10.43. Cili është akti i parë juridik që përfaqëson kushtetutën e parë formale të Shtetit shqiptar?

10.44. Ushtrimi autentik i pushtetit konstituiv derivativ në **Shqipërinë londineze**, për herë të parë ndodhi me mbajtjen e **Kongresit të Lushnjës** (1920), në kohë e rrethana shumë më të ndryshme se ato që kishin ekzistuar para Luftës së Parë Botërore. Diskutoni!

10.45. Diskutoni zhvillimin kushtetues në Shqipërinë londineze nga Statuti i Lushnjës deri te vënia e vendit nën regjimin komunist!

10.46. Për **historinë kushtetuese të shqiptarëve nën ish-Jugosllavi** (1918-1992), me rëndësi janë dokumentet kushtetuese që janë të përbashkëta edhe për vendet fqinje të Kosovës, me përjashtim të Shqipërisë. Cilat janë ato? Diskutoni!

10.47. Gjatë Mbretërisë **SKS/Jugosllavisë** (1918-1943), Kosova nuk ka pasur identitet të veçantë kushtetues e as identitet tjetër politik apo territorial. Ajo nuk ka qenë e njohur si territor i veçantë, kurse popullsia e saj nuk ka gëzuar asnjë njohje kushtetuese. Diskutoni!

10.48. Sa i përket **Kosovës**, zhvillimet kushtetuese kanë kuptim vetëm pas amendamenteve të viteve 1969, 1971 dhe 1972 dhe miratimit të Kushtetutës së KSAK në vitin 1974 dhe pas saj. Diskutoni pse kjo është kështu?

10.49. Me cilën prej kushtetutave jugosllave Kosova ka fituar për herë të parë një ngritje në statusin e saj juridik-kushtetues?

10.50. Ka qenë ardhja në pushtet e diktatorit serb **Sllobodan Milosheviq** në vitin 1986, ajo që ka ndryshuar çdo gjë në nivel jugosllav: nga kjo kohë, në **Serbi** u hap "kutia e Pandorës" së nacionalizmit serb, i cili provokoi fuqishëm edhe nacionalizmat tjerë, në rend të parë atë kroat dhe slloven, por edhe nacionalizmat që deri atëherë kishin qenë të fjetur (maqedonët, myslimanët boshnjakë, hungarezët etj). Në mesin e shumë sloganeve në retorikën nacionaliste serbe të kësaj kohë ka qenë rikthimi i shtetësisë së

Serbisë, të cilën serbët e konsideronin se e kishin humbur me nxjerrjen e **Kushtetutës së RSFJ të vitit 1974**. Diskutoni!

10.51. Miratimi i amendamenteve të datës 23 mars të vitit 1989, me të cilat Kosova humbi dhunshëm dhe nën tytat e pushkës autonominë që kishte gëzuar sipas Kushtetutës së ish-Jugosllavisë të 1974, pati për pasojë reagimin e shqiptarëve në gjysmën e parë të vitit 1990: më 2 korrik u shpall **Deklarata e Pavarësisë së Kosovës,** kurse më 7 shtator 1990 u miratua **Kushtetuta e Kaçanikut**. Diskutoni!

10.52. Serbia i shpallte të tjerët që fitonin pavarësinë si pasojë e dhunës serbe si secesionistë, kurse veten e shpallte si ruajtës dhe trashëgimtar të vetëm legal dhe legjitim të ish-Jugosllavisë, si në planin ndërkombëtare ashtu dhe në aspektin kushtetues. Qasja serbe, që sot e kësaj dite insiston në kontinuitetin shtetëror juridiko-ndërkombëtar dhe kushtetues me ish-Jugosllavinë, bazohet në disa premisa. Në çfarë bazohej premisa e fundit apo premisa kushtetuese serbe lidhur me kontinuitetin shtetëror?

10.53. Në çfarë konsistojnë premisat lidhur kontinuitetin shtetëror juridiko-ndërkombëtar të Serbisë me ish-Jugosllavinë, gjithnjë sipas serbëve?

10.54. Sikundër u tha më sipër, në fund të verës së vitit 1990, u suprimuan të gjitha organet e **KSAK-së,** proces që u kurorëzua me nxjerrjen e **Kushtetutës së Serbisë** (shtator 1990). Në këtë kohë, nga marsi 1989 deri në fund të verës së vitit 1990, **Serbia** në mënyrë graduale e vuri **Kosovën** në tërësi nën thundrën e sistemit të saj juridik-kushtetues, duke rrënuar të gjitha shenjat e identitetit kushtetues që vendi kishte gëzuar me vite sipas kushtetutave të vitit 1974 (të RSFJ-së dhe KSAK-së). Kjo politikë prodhoi rezistencë masive në mesin e popullsisë shumicë në **Kosovë**, e cila deri në fillim të vitit 1998 pati qenë krejtësisht paqësore. Në këtë kohë janë nxjerrë dy dokumente juridiko-kushtetuese me rëndësi historike. Cilat janë ato?

10.55. Kush e hartoi **Deklaratën e 2 Korrikut** dhe **Kushtetutën e Kaçanikut** dhe nën cilat rrethana?

10.56. Paraqitja e **UÇK**-së në skenën publike kosovare ka qenë rezultat imediat i ngritjes dramatike dhe të shpejtë të dhunës dhe represionit serb në Kosovë si dhe i dështimit të rrugës paqësore të presidentit Dr. **Ibrahim Rugova** dhe **LDK**-së. **Kosova** në këtë kohë qe përjashtuar nga çdo proces paqësor që kishte filluar në kontekstin e zgjidhjes së krizës dhe luftës në ish- **Jugosllavi**, siç janë rastet e përjashtimit nga dy konferencat e paqes të mbajtura në **Hagë** (1991-1992) dhe në **Londër** (1992-1995). Diskutoni zhvillimet e mëtejme, duke u fokusuar në aspektet kushtetuese të këtyre zhvillimeve të mëpastajme!

10.57. Në nëntor të vitit 1997, me daljen në skenë të **UÇK**-së, nisi ajo që të gjithë e kishin pritur: konfrontimi i hapur në mes të popullit shumicë të **Kosovës** dhe forcave policore e ushtarake serbe të instaluara në vend. Konflikti i hapur në mes të **UÇK**-së dhe forcave serbe, pas dy vitesh e detyroi bashkësinë ndërkombëtare për t'u vënë në lëvizje, gjatë verës së vitit 1997, për t'u intensifikuar në fund të atij viti. Bashkësia ndërkombëtare, në veçanti amerikanët, e kishin duruar Serbinë deri në fillim të vitit 1999. Pas masakrës së **Reçakut** në janar të vitit 1999, u bë fare e qartë se **Serbia e Millosheviqit** po synonte qëllimin e njëjtë si në **Bosnje-Hercegovinë** dhe **Kroaci**, përkatësisht përfitime territoriale me dhunë dhe përmes spastrimit etnik të kulturave e popujve joserbë. Për të ndaluar një gjë të tillë, bashkësia ndërkombëtare, nën udhëheqjen e vendeve perëndimore dhe **Rusisë**, i a.q. **Grupi i Kontaktit**, thirri një konferencë ndërkombëtare për paqen në Kosovës, e cila u mbajt në **Rambuje** të **Francës**. Këtu u prodhua një dokument me rëndësi kushtetuese për Kosovën. Për çfarë bëhet fjalë?

10.58. **Komisioni i Venecias** pati marrë përsipër kryerjen e një vlerësimi të brendshëm dhe tërësisht konfidencial lidhur me pozitën kushtetuese të Kosovës dhe popullsisë së saj shumicë nën regjimin millosheviqian. Diskutoni!

10.59. **Marrëveshja e Rambujesë** ka përmbajtur dispozita kushtetuese që ishin të modeluara

sipas vijave kryesore të skicuara në raportin e vlerësimit të Komisionit. Në çfarë drejtimi ekziston ngjashmëria në mes të vlerësimit të Komisionit dhe Marrëveshjes?

10.60. **Marrëveshja e Rambujesë** ka një rëndësi të madhe historike e praktike si tekst juridiko – kushtetues, për dy arsye. Cilat janë ato dy arsye dhe cila ka qenë struktura e këtij dokumenti?

10.61. Si shtojcë e parë e **Marrëveshjes së Rambujesë** paraqitet **Kushtetuta e Kosovës**, përkatësisht **Kushtetuta e Rambujesë**, e cila ka pasur preambulën dhe vetëm 11 nene. Njëjtë si në rastin e **Kushtetutës së Bosnje-Hercegovinës**, e cila është pjesë e **Marrëveshjes së Dejtonit**, kjo kushtetutë ka qenë e paramenduar të jetë pjesë e një marrëveshjeje ndërkombëtare, **Marrëveshjes së Rambujesë**. Diskutoni!

10.62. Në pikën e tretë të nenit të parë të kapitullit të tetë dhe të fundit të **Marrëveshjes së Rambujesë** gjendet dispozita famoze që për herë të parë i njihte Kosovës ndërkombëtarisht të drejtën e vendosjes për fatin e saj politik (**të drejtën për referendum**). Në këtë pikë thuhej se pas tri vjetësh do të ndërtohej një mekanizëm për zgjidhjen përfundimtare të statusit të Kosovës në një tubim të serishëm ndërkombëtar. Ky mekanizëm përcaktohej se do të kishte për detyrë të merrte parasysh disa kritere me rastin e vendosjes për statusin përfundimtar të Kosovës. Për çfarë bëhet fjalë këtu? Cilat janë ato kritere?

10.63. Të drejtat dhe liritë themelore sipas përcaktimit të nenit gjashtë ["Të Drejtat dhe Liritë e Njeriut"] dhe shtatë ["Bashkësitë Nacionale"] të **Kushtetutës së Rambujesë** paraqesin modelin pararendës, që më vonë do të ndiqet nga **Korniza Kushtetuese** (2001) dhe **Kushtetuta e Kosovës** (2008). Në sferën e **lirive dhe të drejtave të njeriut** dhe të asaj që tani quhen **komunitetet e Kosovës**, me këtë kushtetutë, në fakt, nis faza e parë të ndërtimit të identitetit të ri efektiv kushtetues të Kosovës, identitet që aspak nuk përputhet me kulturën materiale të shoqërisë kosovare në të gjitha fazat e zhvillimit të saj në të kaluarën. Diskutoni! Tregoni në veçanti se cili dokument kushtetues ka qenë më i gjerë në aspektin e lirive dhe të drejtave të njeriut-Kushtetuta e Rambujesë, Korniza Kushtetuese apo Kushtetuta e Kosovës?

10.64. Normat ndërkombëtare mbi të drejtat dhe liritë njerëzore kanë qenë pjesë përbërëse e rendit juridik kosovar që nga nxjerrja e rregulloreve të ndryshme të **UNMIK**-ut, të cilat si tërësi kishin për qëllimin reformimin e sistemit juridik-kushtetues sipas standardeve më të larta ndërkombëtare të demokracive kushtetuese. Si zbatimi i drejtpërdrejtë ashtu dhe ai i tërthortë, përmes interpretimit të teksteve juridike të rëndësisë kushtetuese, nuk kanë qenë kontestuese sepse ky zbatim ka qenë një detyrim kushtetues për të gjitha autoriteteve publike kosovare. Në praktikë, megjithatë, situata ka qenë më ndryshe: të pakët kanë qenë institucionet e Kosovës që kanë marrë seriozisht vënien në jetë të një detyrimi të tillë. Kjo gjendje nuk pati ndonjë përmirësim as me inicimin e projektit të a.q. **Standardet para Statusit.** Diskutoni! Tregoni se çfarë ka qenë ky projekt, cila ka qenë rëndësia e tij dhe ndikimi?

10.65. Çka është **Rezoluta 1244** e KS të OKB? Çfarë përmban ajo dhe çfarë ka rregulluar pas qershorit 1999?

10.66. Në kuptim hierarkik, **Rezoluta 1244** paraqet "kushtetutën" e **Kosovës** së pasluftës sepse ka qenë dokumenti me fuqi më të lartë juridiko-politike dhe themel i çdo akti juridik (të përgjithshëm apo individual) të nxjerrë nga **UNMIK**-u deri në shpalljen e pavarësisë më 17 shkurt 2008. Ndër aktet juridike të nxjerra në vijim të zbatimit të zotimeve të Rezolutës, dy kanë rëndësi të veçantë për diskutimin tonë në këtë libër. Cilat janë ato akte dhe çfarë rregullonin?

10.67. **Korniza Kushtetuese** paraqet dokumentin më përmbledhës juridiko-kushtetues, i nxjerrë nga UNMIK-u në vijim të zbatimit të detyrës së tij kryesore që e kishte marrë mbi vete konform **Rezolutës 1244**. Ajo detyrë konsistonte në ndërtimin e institucioneve të vetëqeverisjes në vend deri në themelimin e atyre të përhershme që pritej të ndodhte

si rezultat e një marrëveshje politike në mes të palëve, diçka që nuk ndodhi asnjëherë. Edhe ky dokument ka formën standarde përmes së cilës **PSSP**-ja ka ushtruar kompetencat e veta sipas **Rezolutës 1244**, përkatësisht formën e rregullores. Kjo rregullore mban numrin **2001/9** dhe është nënshkruar nga **PSSP**-ja më datën 15 maj 2001. Si në preambulë ashtu edhe në pjesën operative të Kornizës, në syprinë dalin dy qëllime për të cilat është nxjerrë ky dokument me shumë rëndësi për zhvillimin kushtetues të **Kosovës** dhe për historinë e saj bashkëkohore. Për çfarë qëllime bëhet fjalë? Cila ka qenë struktura normative e Kornizës?

10.68. Ndër dispozitat më me rëndësi të **Planit Ahtisari** janë ato të aneksit I ["Dispozitat Kushtetuese "], si dhe ato që garantonin supremacinë (epërsinë) e tij gjatë tërë kohës së pavarësisë së mbikëqyrur. Diskutoni!

10.69. Në të drejtën ndërkombëtare, çdo deklaratë për shpalljen e pavarësisë paraqet një akt të njëanshëm që krijon detyrime **erga omnes** në të cilat mund të thirret çdo kush në bashkësinë ndërkombëtare, secili shtet apo secila organizatë ndërkombëtare. A vlen kjo për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës të datës 17 shkurt 2008? Diskutoni!

10.70. Zhvillimi kushtetues në **Maqedoninë e Veriut** ka kaluar nëpër disa faza. Faza e parë nis me vitin 1880 e deri në gjysmën e parë të shekullit XX. Faza e dytë përfshinë periudhën e gjysmës së dytë të shekullit në fjalë dhe përshinë aktet e konstituimit të këtij vendi si shtet sovran dhe i pavarur dhe ridefinimet e mëpastajme të identitetit kushtetues që kanë të bëjnë me **Marrëveshjen e Ohrit** (2001) dhe **Marrëveshjen e Prespës** (2018). Diskutoni!

10.71. Zyrtarisht, **Mbretëria e Malit të Zi** ka qenë monarki kushtetuese, por në praktikë një monarki absolutiste. Më 28 nëntor 1918, pas mbarimit të **Luftës së Parë Botërore**, me qeverinë e vendit akoma në mërgim, një kuvend jolegal dhe jolegjitim, i njohur si **Kuvendi i Podgoricës**, shpalli shkrirjen e Monarkisë me **Mbretërinë SKS** që u formua tri ditë më vonë, më 1 dhjetor 1918. Diskutoni!

10.72. Autori kryesor i të drejtës kushtetuese në Serbi, **Ratko Markovic**, konstitucionalisti më me ndikim i viteve '90-të të shekullit të kaluar, beson se **Serbia,** jo vetëm që është trashëgimtare e vetme e RFJ-së (1992), por edhe e ish-Jugosllavisë së themeluar më 1 dhjetor 1992 dhe e shpërbërë në prill të vitit 1992. Këtë e bënë me shpresën për të ruajtur "tapitë" mbi Kosovën, siç e bëjnë të gjithë autorët serbë të së drejtës kushtetuese dhe ndërkombëtare, duke besuar se pas shpërbërjes edhe të **RFJ-së** (pas pavarësimit të Malit të Zi), të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga **Rezoluta 1244** do të kalojnë në Serbinë. Pse? Diskutoni argumentet serbe lidhur me këtë!

10.73. Për shkak të rëndësisë së çështjeve që normon, që kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionimin e shtetit dhe pushtetit si dhe me statusin e individit në shoqëri, nuk është gabim të thuhet se e drejta kushtetuese është dega themelore e sistemit juridik. Sipas cilit kriter thuhet kështu?

10.74. Se e drejta kushtetuese ka rëndësi thelbësore për sistemin juridik, mund të konkludohet edhe për faktin se burimi kryesor i të drejtës kushtetuese, kushtetuta, përbën burim të së drejtës për të gjitha degët tjera të së drejtës: administrative, penale, civile dhe të gjitha degëve të tjera. Sipas cilit kriter thuhet kështu?

10.75. Si disiplinë shkencore, e drejta kushtetuese lajmërohet dhe gradualisht zhvillohet në Angli, Francë, Itali, SHBA dhe Gjermani. Në kuptimin bashkëkohor të fjalës, megjithatë, konsiderohet se, për herë të parë është themeluar në **Francë**, pas revolucionit të korrikut 1830, në **Fakultetin Juridik** të **Universitetit të Parisit** (1834). Shkëndijat e para të lindjes së një disipline të re shkencore që do të ketë për objekt studimi të drejtën kushtetuese janë të mëhershme dhe datojnë nga koha pas nxjerrjes së Deklaratës së vitit 1789. Diskutoni!

10.76. Kur u hap katedra e parë e të drejtës kushtetuese, ku dhe kush ishte shef i parë i saj?

10.77. Çka është e drejta kushtetuese institucionale dhe pse quhet kështu?

10.78. Në **Gjermani** është futur në përdorim një shprehje tjetër për të përshkruar materien që sot normon e drejta kushtetuese - shprehja "e drejta shtetërore" (**Staatsrecht**). Pse?

10.79. E drejta kushtetuese si një disiplinë shkencore studion tërësinë e rregullave dhe praktikave që cilësohen si kushtetuese, sipas një metodologjie të caktuar. Metodat e saj, **grosso modo**, mund të përmbledhin në dy grupime. Diskutoni!

10.80. Ajo që më së shumti asocohet me të drejtën publike, historikisht shikuar, është ai grup i rregullave dhe parimeve që formojnë të drejtën kushtetuese. Si degë e së drejtës publike, e drejta kushtetuese përfshinë normat juridike që rregullojnë marrëdhëniet e pushtetit politik. Si në kuptimin material ashtu edhe në kuptimin formal, e **drejta kushtetuese pozitive** përbën degën më të rëndësishme të së drejtës. Pse?

10.81. Rëndësia dhe pozita e normave kushtetuese në të drejtën kushtetuese është i ndryshëm nga rëndësia dhe pozita e tyre në kuadër të degëve të tjera të së drejtës. Në të drejtën kushtetuese, normat kushtetuese shfaqen si **norma fillestare dhe përfundimtare.** Brenda dhe kundrejt krejt degëve të tjera të së drejtës, ndërkaq, normat kushtetuese janë **norma themelore dhe fillestare**. Çfarë do të thotë kjo? Diskutoni!

10.82. **Pelegrino Rosi**, doajeni i të drejtës kushtetuese si degë e shkencës juridike, ka thënë se në të drejtën kushtetuese gjenden kokat e kapitujve të degëve të tjera të së drejtës ("les *têtes* des chapiters"). Çfarë do të thotë kjo?

10.83. E drejta kushtetuese ka më së shumti pika takimi me të **drejtën administrative**, e cila, në kuptimin organik, rregullon pozitën dhe punën e organeve shtetërore – organeve të administratës. Diskutoni!

10.84. E drejta kushtetuese është e lidhur edhe me të **drejtën penale** (materiale dhe procedurale). Diskutoni!

10.85. E drejta kushtetuese dhe e drejta ndërkombëtare kanë marrëdhënie të ngushta. Pse?

10.86. Dallimi standard i burimeve të së drejtës kushtetuese, ndërkaq, nis me dallimin në **burime materiale** dhe **burime formale**. Diskutoni!

10.87. Sipas efektit që prodhojnë, mund të dallohen tri lloje të **zakoneve kushtetuese**. Diskutoni!

10.88. Kushtetuta qëndron në majën më të lartë nga të gjitha burimet e të drejtës kushtetuese. Kushtetuta është një akt i shkruar, sipas rregullit i kodifikuar (në një tekst unik). Ka raste kur ajo nuk haset në një dokument të vetëm të shkruar dhe të kodifikuar, por në disa sosh. Diskutoni!

10.89. Gjurmët e idesë sipas së cilës normat kushtetuese nuk kanë fuqinë e njëjtë juridike e gjejmë te konstitucionalisti **Karl Shmit**, i cili, duke iu referuar **Kushtetutës së Vajmarit** (1919), në veprën e tij monumentale, botuar në mes të dy luftërave botërore, konstatoi se ekzistonin disa dispozita që nuk mund të amendamentoheshin asnjëherë, sepse përbënin bërthamën e identitetit të shtetit, Për çfarë bëhet fjalë këtu?

10.90. **Kosova** dhe disa nga vendet përreth kanë dispozita që ngjasojnë me **doktrinën e amendamenteve kushtetuese kundërkushtetuese**. Diskutoni! Cili është dallimi në mes të Kosovës dhe vendeve përreth dhe vendeve të tjera që njohin kategorinë e amendamenteve kushtetuese kundërkushtetuese?

10.91. Çka janë rezervatet kushtetuese?

10.92. Çka janë amendamenet kushtetuese?

10.93. Fakti që në disa vende, përfshirë **Kosovën**, ekziston juridiksioni i gjykatës kushtetuese për vlerësim të kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara nuk nënkupton që amendamentet kanë fuqi më të ulët juridike se kushtetuta ekzistuese. E njëjta vlen, **mutatis mutandis**, edhe për rastet kur në disa kushtetuta bëhet dallimi në mes të procedurës së amendamentimit dhe rishikimit (revizionit) kushtetues: në dy rastet bëhet fjalë për ndryshime kushtetuese. Sipas rregullit, caqet e këtij ndryshimi janë më të thella dhe më radikale te rasti i rishikimit. Për këtë arsye edhe bëhet dallimi në mes të **rishikimit të pjesshëm** dhe **rishikimit total**. Diskutoni!

10.94. Dallimi i vetëm mes amendamenteve dhe dispozitave kushtetuese pas prodhimit të tyre, ka të bëjë me situatat e ”klauzolave të përjetësisë” apo **dispozitat e paamendamentueshme kushtetuese**. Diskutoni!

10.95. Amendamentet kushtetuese miratohen pas kushtetutës. Shpeshtësia e prodhimit të tyre diktohet nga nevojat e shoqërisë dhe rrethanat politike (konsensusi i gjerë shoqëror, intensiteti i mosmarrëveshjeve dhe konfliktit politik në mes të grupeve shoqërore etj.). Në këtë kuptim, njihen **dy teknika të amendamentimit**. Cilat janë ato dhe çka dallojnë ndërmjet veti?

10.96. Përveç Indisë, edhe kushtetutat e disa vendeve të tjera që i përkasin **Komonueltit Britanik** (ish-kolonitë britanike) përmbajnë shtojca dhe anekse, të draftuara dhe miratuara me të njëjtin qëllim sikur në rastin indian. Ka raste kur vetë kushtetuta është **aneks** i një dokument tjetër, pra një situatë krejt e kundërt me Indinë. Cili është ai rast kur kushtetuta është ankes i një dokumenti tjetër?

10.97. **Ligji kushtetues** është burim formal i të drejtës kushtetuese dhe nën këtë emër mund të futen (dhe zakonisht futen akte të ndryshme juridike. Ligji kushtetues është sikur kushtetuta, akt me fuqi juridike kushtetuese. Kur me te ndryshohet ose plotësohet kushtetuta, atëherë ai ka fuqi juridiko-kushtetuese. Në rastet kur nuk ndryshojnë ose plotësojnë kushtetutën, statusi dhe fuqia juridike e ligjit kushtetues ndryshon. Për këtë arsye, ai mund të futet në kategorinë e burimeve të së drejtës që kanë fuqinë juridike ndërmjet kushtetutës dhe ligjit të zakonshëm dhe ka disa forma manifestimit. Cilat janë ato?

10.98. Pa pasur dispozita kushtetuese që në mënyrë shprehimore përcaktojnë materien që duhet të mbulohet me ligje organike nuk mund të ketë ligje të tilla, pa marrë parasysh se disa nga to mund të nxirren më shumicë të kualifikuar dhe me procedurë të posaçme dhe të vështirësuar. Është kushtetuta nacionale, me fjalë të tjera, ajo që autorizon nxjerrjen e ligjeve organike dhe definon materien të cilën e mbulojnë ligjet e tilla. Kështu është në **France**, **Kroaci**, **Spanje, SHBA** dhe në shume vende të tjera të botës. Çfarë do të thotë kjo?

10.99. Pse ligjet nga neni 81.1 i Kushtetutës së Kosovës nuk janë ligje organike?

10.100. Cili është dallimi në mes të ligjeve organike dhe ligjeve të zakonshme?

10.101. Kur janë ligjet e zakonshme burim i të drejtës kushtetuese?

10.102. Çfarë burimi i të drejtës kushtetuese janë aktet nënligjore dhe me cilin kusht?

10.103. Vendimet e gjykatave kushtetuese që vlerësojnë kushtetutshmërinë e një akti, krijojnë rregulla të reja të sjelljes. Kjo sepse gjykatat kushtetuese, në parim, janë **ligjvënës negativ**, siç e ka cilësuar **Hans Kelsen**. Çfarë do të thotë kjo?

10.104. Kushtetutat bashkëkohore çdo ditë e më shumë i kushtojnë një rëndësi të posaçme rregullimit të marrëdhënies në mes të drejtës vendore dhe të drejtës së huaj (asaj ndërkombëtare dhe të drejtës që prodhohet në shtete e huaja). Në vijim të këtij normimi, dallohen tri burime të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare: **rregullat përgjithësisht të pranuara të së drejtës ndërkombëtare**, **marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare** dhe **e drejta e organizatave të ndryshme ndërkombëtare**. Këto janë burime ndërkombëtare të së drejtës kushtetuese dhe dallohen nga burimet e huaja, që përfshijnë edhe burimet eventuale që kanë origjinë në një shtet të huaj. Diskutoni! Në veçanti sqaroni nëse këto janë burime materiale apo burime formale të së drejtës kushtetuese.

10.105. **Kushtetuta e Kosovës** është miratuar më 9 prill 2008 nga Kuvendi i Kosovës, që ka vepruar si ushtrues i pushtetit konstituiv derivativ në vijim të zbatimit të **grundnormës** së vet- **Deklaratës së Pavarësisë** (17 shkurt 2008). Ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008, tre muaj pas miratimit. Aktualisht ka 162 dhe është amendamentuar njëzetë e gjashtë herë. Sa i përket aspektit funksional, Kushtetua qartë përcakton **modelin konsociacional të demokracisë**. Diskutoni!

10.106. **Kushtetuta e Kosovës** nuk përdor shprehjen **akte nënligjore**. Në fakt, ajo nuk përdor as shpre-

hjen **akte juridike**. Për këtë arsye në klasifikimin e burimeve të së drejtës kushtetuese ne nisemi prej klasifikimit standard të ndjekur nga shkenca juridike-kushtetuese. Diskutoni!

10.107. **Kushtetuta e Kosovës** normon rolin dhe pozitën e të drejtës ndërkombëtare në sistemin juridik-kushtetues, njëjtë siç bëjnë vendet përreth. Në këtë kuptim **mund të veçohen disa kategori të së drejtës ndërkombëtare** që kanë relevancë kushtetuese, sepse mund të shërbejnë si burim i të drejtës kushtetuese kur objekt i tyre i rregullimit janë marrëdhëniet juridiko-kushtetuese (**materia kushtetuese**). Cilat janë këto kategori?

10.108. Në nenin 116 të **Kushtetutës së Shqipërisë**, aktet normative ndahen në tri kategori. Cilat janë ato?

10.109. Cilat janë burimet e të drejtës kushtetuese në Shqipëri dhe çfarë dallojnë ato prej burimeve të së drejtës kushtetuese kosovare?

10.110. Cilat janë burimet e të drejtës kushtetuese në Maqedoninë e Veriut dhe çfarë dallojnë ato prej burimeve të së drejtës kushtetuese kosovare?

10.111. Cilat janë burimet e të drejtës kushtetuese në Mal të Zi dhe çfarë dallojnë ato prej burimeve të së drejtës kushtetuese kosovare?

10.112. Cilat janë burimet e të drejtës kushtetuese në Serbi dhe çfarë dallojnë ato prej burimeve të së drejtës kushtetuese kosovare?

10.113. Procedura kushtetutëbërese përbëhet prej **veprimeve faktike** dhe **veprimeve juridike**. Diskutoni!

10.114. Pushteti që krijon kushtetutën quhet **pushtet konstituiv** dhe ka dy trajta themelore. Diskutoni!

10.115. Ka mjaft kushtetuta që, në vijim të diskutimit të procedurës për miratim të kushtetutës dhe ndryshimeve në të, nuk lejojnë fare mundësi për ndryshim në pjesë të caktuara. Thjeshtë, me kushtetutën e parë disa dispozita të saj shpallen si të paamendamentueshme (nuk mund të ndryshohen në asnjë rrethanë). Për çfarë bëhet fjalë këtu? Diskutoni duke përmendur disa kushtetuta të Evropës, si shembuj konkret.

10.116. Pse kushtetutëbërësit e parë kanë liri të pakufizuar të vendosjes, përkatësisht nuk janë të lidhur për një kuadër juridik paraprak?

10.117. Në kohën e miratimit të kushtetutës së radhës, ose ndryshimit të kushtetutës ekzistuese, ekzistojnë rregulla mbi procedurën e bërjes së kushtetutës. Pra, në këtë kohë ushtrimi i pushtetit konstituiv ka natyrë derivative sepse bazohet në rregulla të përcaktuara kushtetuese për kushtetutëbërje. Sa i përket asaj se sa respektohet rregullat ekzistuese mbi kushtetutëbërjen, dallohen dy trajta të realizimit të tyre: **kontinuiteti** dhe **diskontinuiteti**. Çfarë nënkuptohet me këto dy shprehje?

10.118. Mjaft i dobishëm është dallimi në mes të ndryshimit formal dhe faktit të kushtetutës, për shkak se bëhet fjalë për fenomene të ndryshme që hasen në konstitucionalizmin bashkëkohor. Për çfarë bëhet fjalë këtu?

10.119. Tradicionalisht, **kuvendi kushtetues** apo **konstituanta** është krijuar dhe thirrur vetëm për të miratuar kushtetutën, pastaj është shpërbërë (Franca, Gjermania e Vajmarit, India pas pavarësimit, Indonezia pas pavarësimit, Italia pas Luftës së Dytë Botërore, SHBA, ish-Jugosllavia mbretërore pas Luftës së Parë Botërore, etj.). Pra bëhet fjalë për situatat kur ka ndërprerje në zhvillimin e deriatëhershëm kushtetues, pra kur ka diskontinuitet, si pasojë e ndryshimeve radikale në statusin politik të entitetit që miraton kushtetutën e parë. Kjo nuk do të thotë se kushtetutat ekzistuese nuk përmbajnë dispozita mbi **asambletë kushtetuese**, duke sanksionuar në këtë mënyrë ushtrimin e pushtetit konstituiv origjiner brenda kornizës së përcaktuar kushtetuese. Cilat vende kanë një zgjidhje të tillë kushtetuese?

10.120. **Dy përbërje të parlamentit** vendosin për ndryshime kushtetuese apo miratim të kushtetutës së re kur përbërja e parë merr vendim për nisjen e procedurës për një gjë të tillë dhe më pastaj shpërbëhet, kurse përbërja e re miraton ndryshimet e propozuara apo kushtetutën e re. Cilat vende kanë zgjidhje të tilla kushtetuese që vendosin për miratim të kushtetutës së re apo për ndryshime kushtetuese?

10.121. Cilat lloje të **referendumit kushtetues** ekzistojnë dhe kush mund të jenë subjektet që mund të

nisin procedurën e kushtetutëbërjes?

10.122. Cilat janë cilësitë e ndryshimit faktik të kushtetutës? Çka dallojnë ato nga ndryshimi formal?

10.123. Arsyet për instalim të **demokracisë konsociacionale** në **Kosovë** janë kryesisht të natyrës historike. Pse?

10.124. Çdo ndryshim i **Kushtetutës së Kosovës** komandohet nga dispozitat e nenit të saj 144, që normon amendamentimin. Ky nen duhet të lexohet në dritën e doktrinës mbi amendamnetet jokushtetuese, përkatësisht së bashku me **klauzolën kosovare të përjetësisë** që ankorohet në kapitullin e dytë të Kushtetutës. Diskutoni!

10.125. Aktualisht mund të vërehen tri kategori të dispozitave mbi **klauzolat e përjetësisë** në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut, që janë futur në kushtetuta të botës së qytetëruar me qëllim të mbrojtës së demokracive vendore. Diskutoni!

10.126. Si ndahen kushtetutat sipas cilësive të tyre politike?

10.127. Si ndahen kushtetutat sipas cilësive të normave të tyre?

10.128. Si ndahen kushtetutat bazuar në rrethanat shoqërore dhe historike të kohës së krijimit të tyre?

10.129. Si ndahen kushtetutat sipas kriterit të zbatueshmërisë së kushtetutave, përkatësisht bazuar në kriterin ontologjik (marrëdhënia e kushtetutave ndaj realitetit)?

10.130. Si ndahen kushtetutat sipas formës së qeverisjes që instalojnë?

10.131. Si ndahen kushtetutat bazuar në kriterin e organizimit të pushtetit?

10.132. Ndarja e parë klasike e kushtetutave sipas formës në të cilën shfaqen është ajo e **kushtetutave të shkruara** dhe **kushtetutave të pashkruara.** Çfarë raporti kanë këto kushtetuta me **kushtetutat e kodifikuara** dhe **kushtetutat e pakodifikuara**? A ka dallim mes tyre apo bëhet fjalë për fenomenin e njëjtë?

10.133. Si ndahen kushtetutat sipas asaj kush sjell apo kush krijon kushtetutën?

10.134. Si ndahen kushtetutat bazuar në kriterin e ndërlikueshmërisë së procedurës së kushtetutëbërjes?

10.135. Kushtetutat ndahen në disa njësi më të ngushta. Si akte juridike, ato kanë vëllime të ndryshme që formohen sipas ngjashmërisë tematike të materies kushtetuese që kodifikohet me to. Sistematika e kushtetutës e përbëhet nga njësitë e sistematizimit, në të cilat gjenden një ose më shumë norma kushtetuese. Sipas radhitjes nga më e vogla kah më e madhja, cilat janë ato njësi?

10.136. Çka është preambula dhe çfarë dallon nga pjesa operative?

10.137. Cili është funksioni primar i preambulës?

10.138. Cila është struktura e Kushtetutës së Kosovës dhe çfarë dallon nga struktura e **KShq**?

10.139. Cila është struktura e Kushtetutës së Kosovës dhe çfarë dallon nga struktura e **KMVer**?

10.140. Cila është struktura e Kushtetutës së Kosovës dhe çfarë dallon nga struktura e **KMZi**?

10.141. Cila është struktura e Kushtetutës së Kosovës dhe çfarë dallon nga struktura e KSerb?

10.142. Mund të mendohet se ka qenë e drejta ndërkombëtare ajo që së pari ka ndërtuar kriteret apo elementet e qenies shtet. Kjo, në fakt, nuk është kështu. Ka qenë **doktrina austriake e të drejtës publike** ajo që e para ka formuluar kriteret themelore të qenies shtet. Diskutoni!

10.143. Aktualisht përqafohet mendimi se shteti përbëhet nga tri elemente: territori, popullsia dhe pushteti. Të kthehemi tani te **territori shtetëror**, si element material i shtetit. Ai përfaqëson territorin shtetëror që përkufizohet me kufij. Çdo shtet ka territorin e vet, një hapësirë mbi sipërfaqe dhe çdo gjë që gjendet nën të, pastaj popullsinë që jeton aty dhe, në fund, pushtetin shtetëror që ushtrohet në atë territor. Territori është **element material** i shtetit, për dallim nga popullsia, që përbën **elementin personal**. Elementi i tretë, **pushteti**, lidh dy elementet e tij në një bashkësi të tërësishme të njerëzve. Bashkësia shtetërore dallon nga bashkësitë tjera shoqërore pikërisht për shkak të **pushtetit politik**. Diskutoni elementet e shtetit një nga një!

10.144. Shtetet mund të **ndahen** sipas kritereve të ndryshme: antropologjike dhe etnologjike (popullsia), ekonomike (pasuria), gjeografike (sipërfaqja dhe relievi). Kriteret tona, ndërkaq, janë të karakterit **juridiko-kushtetues**, krejtësisht të ndryshme nga secili prej kritereve si më sipër. Cilat janë ato kritere bazë të natyrës juridiko-kushtetuese?

10.145. Në Greqinë e vjetër është bërë dallim në mes të konceptit **politeia** dhe rregullave të njohura si **nomos**. Diskutoni, duke përfshirë dallimin e afërt që kanë kultivuar romakët!

10.146. Konstitucionalizmi modern ka lindur nga **ideologjia e liberalizmit**, së cilës në mënyrë graduale iu janë shtuar idetë social-demokratike mbi kushtet më të mira të punës dhe sigurimin social. Për këtë arsye cilësohet si konstitucionalizëm liberal dhe liberal-demokratik dhe ka disa parime mbi të cilat janë ndërtuar shtete demokratike sot. Cilat janë ato?

11. Lexim shtesë

- Alain Delcamp, "La notion de loi organique relative au Sénat: entre affirmation du bicamérisme et parlementarisme rationalisé". *Revue française de droit constitutionnel* Vol. 3 No. 87 (2011)
- Arta Vorpsi, "Ne, populli...". reflektim mbi efektin juridik të preambulës kushtetuese". *Jeta Juridike* Nr. 1 (Tiranë, 2021)
- Bertrand Mathieu et Michel Verpeaux (eds.), *Les lois organiques et la mise en œuvre de la révision constitutionnelle* (DALLOZ: Paris, 2009)
- Claude Klein and Andras Sajo*, "*Constitution-Making: Process and Substance". Në Michael Rosenfeld and Andras Sajo (eds.), *Comparative Constitutional Law*
- Diana Johnstone, "Rambouillet Agreement Explained". *DIALOGUE* Vol. 8 No. 29-30 (Mars-Juin 1999)
- Gary Jeffrey Jacobsohn and Yaniv Roznai, *Constitutional Revolution* (Yale University Press: New Haven and London, 2020)
- Gordana Siljanovska-Davkova, "Political Parties, Values, and Democratic Consolidation". Në Sabrina P. Ramet, Ola Listhaug, and Albert Simkus (eds.), *Civic and Uncivic Values in Macedonia Value Transformation, Education, and Media* (Palgrave Macmillan: New York, NY: 2013)
- Heike Krieger, *The Kosovo Conflict and International. An Analytical Documentation 1974-1999* (Cambridge University Press: Cambridge, 2001)
- Mark Tushnet, "Constitution". Në Michael Rosenfeld and Andras Sajo (eds.), *Comparative Constitutional Law*
- Michel Troper, "Sovereignty". Në Michael Rosenfeld and Andras Sajo (eds.), *Comparative Constitutional Law*
- Momir *Milojević*, "*Kontinuitet i diskontinuitet* državnog pravnog *poretka*". *Anali Pravnog fakulteta u Begoradu* Vol. 49 Br. 1-4 (2001)
- Peter Hilpold, *Kosovo and International Law. The ICJ Advisory Opinion of 22 July 2010* (Martinus Nijhoff Publishers: Leiden, Boston: 2012)
- Stephen Gardbaum*, "*The Place of Constitutional Law in the Legal System". Në Michael Rosenfeld and Andras Sajo (eds.), *Comparative Constitutional Law* (Oxford University Press: Oxford, 2012)
- Stephen Holmes*, "*Constitutions and Constitutionalism". Në Michael Rosenfeld and Andras Sajo (eds.), *Comparative Constitutional Law*
- Sujit Choudhry, "Secession and post-sovereign constitution-making after 1989: Catalonia, Kosovo, and Quebec". *International Journal of Constitutional Law* Vol. 17 No. 2 (June 2019)

PJESA E DYTË 2

LIRITË DHE TË DREJTAT E NJERIUT

1. Përgjithësisht mbi liritë dhe të drejtat e njeriut

Tregimi për të drejtat e njeriut nis me antikitetin, përkatësisht me **sofistët grekë**[1] dhe traditën e mëpastajme në **Romë**. Botëkuptimet ishin se njerëzit janë të barabartë, për nga natyra e gjërave, kurse e drejta, në përgjithësi, vlen për krejt njerëzit.[2] Kuptimi i të **drejtës natyrore** ka ndryshuar në Mesjetën kristiane: tanimë ajo ishte shndërruar në një shprehje të vullnetit hyjnor, jo si diçka që u shkon përshtati të gjithë njerëzve. Si e tillë, e drejta natyrore ka qenë e përjetshme dhe qëndruar mbi ligjin njerëzor, i cili, nëse tregohet i padrejtë, mund të zëvendësohet. Ky qëndrim, arsyetimin teorik e ka gjetur në veprat e teologëve kristianë, në veçanti në pikëpamjet e **Shën Augustinit** (Saint Augustine: 354-430) dhe **Toma Akuinit** (Thomas Aquinas: 1225-1274), filozofëve teolog më me ndikim në këtë periudhë.[3]

Konceptit të lirive dhe të drejtave të njeriut, siç e hasim në kushtetutat bashkëkohore, i kanë paraprirë botëkuptimet mbi arsyen njerëzore si krijues i të drejtës pozitive, në kuadër të së cilës më të vjetrat dhe më të rëndësishmet janë të drejtat e lindura dhe natyrore të secilit njeri. Arsyetimin teorik këto koncepte e gjejnë të shprehur te **Tomas Hobs** (Thomas Hobbes: 1588-1679), **Xhon Lloku** (John Locke: 1632-1704) dhe **Zhan Zhak Ruso** (Jean-Jacques Rousseau: 1712-1778).[4] Vetë kushtetutat moderne, jo vetëm liritë dhe të drejtat e njeriut, janë produkt i arsyes njerëzore, jo i vullnetit hyjnor.

Me kalimin e kohës, teoria e të drejtave natyrore u racionalizua, siç u racionalizua vetë e drejta natyrore, në Mesjetën e vonë dhe modernitetin e hershëm: nga teoria e të drejtave natyrore u mor ideja se **njeriu lind i lirë**, me krejt të drejtat dhe liritë që i takojnë si qenie e gjallë njerëzore. Nisur nga ajo që liritë dhe të drejtat e njeriut janë një dukuri natyrore dhe universale, me aktin më të lartë juridik, me kushtetutë, krejt njerëzve duhet t'iu garantohet korpusi i njëjtë i lirive dhe të drejtave, pa marrë parasysh ku jetojnë. Liritë dhe të drejtat e njeriut të garantuara me kushtetutë janë arritje e vonshme, rezultat i luftërave dhe përpjekjeve politike, dhe u prodhuan me vetëdije. Me nxjerrjen e kushtetutave të para të shkruara, në fund të shek. XVIII, ato pranohen si liri nga shteti, sundimtari, pushteti, ani se kishin ekzistuar kaherë ndër shekuj e vite. Me këtë nis dallimi në mes të drejtave natyrore dhe të drejtave të tjera që janë prodhuar si rezultat i arsyes njerëzore. Kjo ka ndodhur si pasojë e ndryshimit të botëkuptimeve mbi natyrën dhe origjinën e pushtetit shtetëror.

---

1 Ideja e karakterit të përjetshëm dhe universal të lirive dhe të drejtave të njeriut te sofistët bazohet në faktin se qeniet njerëzore, për dallim nga qeniet tjera, janë qenie të arsyeshme dhe kanë një pikëpamje të caktuar mbi hyjnitë. Përveç kësaj, te sofistët njerëzit kanë të drejta ndaras nga ato që iu takojnë si pjesëtarë të klasës së caktuar (privilegjet e shtresave të caktuara).Sofistët, në diskutimet e tyre për drejtësinë, kanë provuar të gjejnë përgjigjen në atë nëse drejtësia rrjedh nga trajtimi i barabartë i njerëzve apo nga e drejta e më të fortit. Cf. Stephan Kirste, "*The Formal and Substantive Core of Human Rights". Humanities and Rights Global Network Journal* Vol. 1 No. 1 (2019) fq. 21-59 në fq. 31-33.

2 Për traditën romake, shih më shumë te Aleksandar Molnar, *Rasprava o demokratskoj i ustavnoj drzavi: 1. Pravo na otpor tiraniji* (Samizdat B92: Beograd, 2001), fq. 79-143.

3 Aleksandar Molnar, *Rasprava o demokratskoj i ustavnoj drzavi: 1. Pravo na otpor tiraniji*, fq. 171-177; Anton-Hermann Chroust, "The Philosophy of Law of St. Augustine". *The Philosophical Review* Vol. 53, No. 2 (Mar., 1944), fq. 195-202.

4 Padam Nepal, "Revisiting the Ideas of Hobbes, Locke and Rousseau in an Ecopolitical Context" *The Indian Journal of Political Science* Vol. 71 No. 3 (July – September 2010), fq. 795-804.

Liritë dhe të drejtat e njeriut, nga koha e formimit të **shteteve borgjeze** në gjysmën e dytë të shek. XVIII dhe përgjatë shek. XIX, zhvillohen kryesisht në themele të ideologjisë liberale, veçanërisht sa i përket **lirive dhe të drejtave personale** (vetjake) dhe **politike**. Mbi këtë bazë vjen deri te ndryshimi i botëkuptimit mbi pushtetin: sundimtari më nuk është përfaqësues i hyjnisë dhe pushtetar i pakufizuar, por bartës i një pushteti që ka origjinë njerëzore, nga kjo botë dhe, për pasojë, është i kufizuar dhe i zëvendësueshëm. Do të zëvendësohet më një pushtet tjetër atëherë kur nuk respekton liritë dhe të drejtat njerëzore. Në atë kohë, **ideologjia liberale borgjeze** merr konceptin e ekzistimit të të drejtave natyrore, mbi të gjitha të drejtës për jetë, liri dhe pronë, duke ndërtuar përmes tyre botëkuptimin mbi **individualitetin**, përkatësisht mbi të drejtat e individit që quhet qytetar (shtetas). Kjo qasje reflektohet edhe në vetë titullin e dokumentit të parë kushtetues të **Revolucionit Francez** (1789) – **Deklaratës së të drejtave të njeriut dhe qytetarit**,[5] e cila, përkundër që në tërësi mbështetet në të drejtat natyrore të njeriut, e bënë të qartë se krahas të drejtave të njeriut ekzistojnë edhe të drejtat njerëzore si qytetar**, si lojalitet ndaj një të drejte pozitive kushtetuese**, e cila sanksionon rolin dhe pozitën e individit në shoqëri. E thënë ndryshe, të drejtat natyrore, të lindura dhe që i takojnë individit si qenie njerëzore, për herë të parë Deklarata i përkthen në **një dokument pozitiv kushtetues**, me qëllim parësor kufizimin e pushtetit politik absolut dhe të pakufizuar të monarkëve francezë të kohës. **Xhorxh Jellinek** (Georg Jellinek: 1851-1911), në një vepër të tij të vitit 1895,[6] sqaron në detaje përse ndikimi i Kushtetutës se ShBA-së ka qenë vendimtar në tekstin e Deklaratës së vitit 1789 (e miratuar, siç u pa më sipër, më 26 gusht 1789). Këtë sqarim, ky autor e ka bërë duke u mbështetur në **metodën krahasimore**, me synimin për t'iu dhënë lirive dhe të drejtave një karakter universal, përkundër që ai vetë ka qenë prijatar i **pozitivizmit**, rrymë sipas së cilës me vlerë dhe e zbatueshme është vetëm ajo normë që ka prapa vullnetin e shtetit, i cili edhe vet shpërfaqet në një fenomen juridik (së bashku me krejt të drejtën të cilën e krijon).[7] Kjo nënkupton që, sipas rregullit, qasja e **Xh. Jellinek** do të duhej të ishte e kundërt me karakterin universal të lirive dhe të drejtave të njeriut, përkatësisht të angazhohej për karakterin e tyre pozitivist dhe të ngushtë nacional.

Duke u mbështetur, siç u tha, në qasje thellësisht krahasimore, **Xh. Jellinek** e nis sqarimin me autorët francezë, duke treguar se vepra e kryesore e **Zhan Zhak Rusosë**, botuar në vitin 1762, e njohur si "Mbi kontratën sociale apo parimet e të drejtës politike" ("Du contrat social ou Principes du droit politique"), nuk ka qenë dhe nuk ka mund të jetë burim inspirimi për Deklaratën e vitit 1789, për faktin e thjeshtë se, sipas teorisë së kontratës sociale, individi bartë pakthim te shteti çdo të drejtë individuale dhe ngelë tërësisht nën pushtetin ekskluziv të shtetit.[8] Përveç kësaj, me një elokuencë të pashoqe, **Jellinek** bën analizën e burimit real të kësaj Deklarate: duke analizuar kartat mbi të drejtat e njeriut, të nxjerra nga 13 ish-kolonitë britanike të Amerikës së Veriut, konstaton se inspirim i vërtetë i Deklaratës së vitit 1789 kanë qenë pikërisht këto ish-koloni britanike, në veçanti **Deklarata e Shtetit Virxhinia mbi liritë dhe**

---

5 Frëngjisht: "Déclaration des droits de l'homme et du citoyen de 1789". Është miratuar më 26 gusht 1789 nga **Asambleja Kushtetuese Nacionale** dhe përfaqëson dokumentin kushtetues me rëndësi kolosale sa i përket të **drejtave civile**. Për tekstin e saj të plotë, në gjuhën angleze, cf. Book Chapter: "1. The Declaration of the Rights of Man and the Citizen, 1789". Në Aroline Warman (ed.). *Tolerance: The Beacon of the Enlightenment* (1st ed., Vol. 3). Open Book Publishers (2016). Në internet: http://www.jstor.org/stable/j.ctt19b9jvh (shikuar në prill 2022), fq. 11-13.E frymëzuar nga filozofët e **Iluminizmit**, Deklarata ka qenë shpallje e vlerave thelbësore të **Revolucionit Francez** dhe ka pasur ndikim të jashtëzakonshëm në zhvillimin e botëkuptimeve popullore mbi lirinë individuale dhe demokracinë në Evropë dhe nëpër botë gjithandej. Cf. Arista Maria Cirtautas, France. Në Jeffrey Kopstein, Mark Lichbach (eds.), *Comparative Politics Interests, Identities, and Institutions in a Changing Global Order* (Cambridge University Press: Cambridge, 2000), fq. 70-104 në fq. 72.Periudha e **Iluminizmit**, e njohur gjithashtu edhe si koha e arsyes, apo thjeshtë si Iluminizmi, ka qenë një lëvzije intelektuale e filozofike që ka dominuar Evropën përgjatë shekujve 17-të dhe 18-të, me ndikim dhe efekte globale. **Iluminizimi** ka përfshirë një mori idesh të përqendruara rreth vlerës që ka lumturia njerëzore, ndjekjes së dijes së fituar përmes arsyes dhe dëshmisë së shqisave njerëzore, si dhe të idealeve siç janë: **liria**, progresi, toleranca, vllazëria në mes të njerëzve, qeverisja kushtetuese dhe, së fundi, ndarja e fesë nga shteti.

6 Georg Jellinek, *The Declaration of the Rights of Men and Citizens* (Henry Holt and Company: New York, 1901).

7 Michel Rosenfeld and Andras Sajo, "Introduction". Në Michel Rosenfeld and Andras Sajo (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law* (Oxford University Press: Oxford, 2012) fq. 2-21 në fq. 5.

8 Ibid., fq. 8-12.

të drejtat e njeriut (miratuar më 12 qershor 1776). Kjo provohet edhe me faktin se vetë propozuesi i saj ka qenë ushtaraku dhe aristokrati **Markezi i Lafajetit** (Marquis de Lafayette: 1757-1834), revolucionari francez që kishte luftuar më parë për lirinë e ShBA-ve.[9]

Sot e kësaj dite bëhet dallimi në mes të kategorisë së të drejtave që u takojnë individëve si qenie njerëzore, përkatësisht në mes të **lirive dhe të drejtave të tyre natyrore**, në njërën anë dhe, në anën tjetër, kategorisë së dytë të lirive dhe të drejtave kushtetuese, përkatësisht **lirive dhe të drejtave që janë pozitive** (produkt i mendjes dhe aktivitetit të vetëdijshëm dhe me vullnet të njeriut). U mor vesh, në kushtetuta dhe ligje pozitive nuk bëhet ky dallim, përfshirë **Kosovën** dhe vendet përreth. Ky dallim është krejtësisht doktrinar. Çdo gjë që normohet me norma juridike i takon të drejtës pozitive dhe gëzon mbrojtjen e shtetit, përkundër asaj që një pjesë e fenomenit që normohet ka origjinë të thellë nga e drejta natyrore – nga vetë qenia njerëzore si qenie e gjallë inteligjente. E drejta pozitive është vullnet politik i kthyer në norma dhe nuk ka nevojë të arsyetojë origjinën e vet. Ky përpunim i të drejtave natyrore përmes normave të së drejtës kushtetuese pozitive ka zgjatur deri në momentin kur është formuar bindja e përgjithshme se liritë dhe të drejtat personale dhe politike të qytetarit duhet të jenë themel i sistemit juridik demokratik. Me fjalë të tjera, të drejtat individuale realizohen dhe mbrohen vetëm në shtetin borgjez të proveniencës **liberale-perëndimore**, aty ku shoqëria ndërtohet mbi barazinë në të drejta dhe liri të secilit anëtar të shoqërisë. Në këtë kuptim, ky shtet ka qenë lehtësisht i dallueshëm nga shteti pararendës, që bazohej në shtresëzime shoqërore dhe pabarazi që lindnin si pasojë e ndarjes në shtresa: shteti feudal ka qenë shtet i njerëzve juridikisht të pabarabartë, në të cilin disa shtresa, aristokratët, kleri, oborrtarët etj., kanë gëzuar më shumë të drejta e liri se anëtarët tjerë të shoqërisë.

Liritë dhe të drejtat e njeriut **përcaktojnë kufijtë deri ku shtrihet veprimi shtetëror i pushtetit dhe ku fillon privatësia e individit.** Pushteti demokratik nuk synon dhe nuk mund të lejojë tejkalimin e kufijve që vejnë liritë dhe të drejtat e njeriut (pacenueshmëria e banesës, letrave dhe korrespondencës, liria e lëvizjes dhe kështu me radhë), përveç situatave qartë të përcaktuara me kushtetutë dhe ligje, në interes të përgjithshëm dhe në mënyrë proporcionale, për aq sa një gjë e tillë është krejtësisht e domosdoshme në një shoqëri demokratike, duke ndjekur arritjen e një qëllimi legjitim. Liritë dhe të drejtat e njeriut i japin mundësi individit që nga shteti të kërkojë dhe fitojë diçka, jo vetëm të mbrohet nga ai. Në këtë kuptim, shteti duhet të krijojë mundësitë për shfrytëzim të lirive dhe të drejtave politike dhe të kujdeset për kushtet shoqërore, ekonomike, kulturore dhe arsimore në të cilat jeton dhe vepron individi.

Liritë dhe të drejtat e njeriut përcaktojnë jo vetëm kufijtë e aktivitetit të shtetit ndaj individit, por edhe anasjelltas - kufijtë e veprimit të individit në shoqëri. Në jetën e përditshme, liritë dhe të drejtat e disave kufizohen nga liritë dhe të drejtat e qytetarëve të tjerë. Kështu, ta zëmë, liria e lëvizjes nuk nënkupton liri pafund dhe pa asnjë kufizim për të hyrë në shtëpi ose pronë të tjetrit, sepse ekziston kufizimi me lirinë dhe të drejtën e tjetrit për pronë dhe pacenueshmëri të shtëpisë së banimit. Për këtë arsye, liritë dhe të drejtat e njeriut nuk duhet të shihen, siç mendohet gabimisht, si pengesa të vëna ndaj shtetit, i cili nuk përfaqëson "armikun" e tyre të vetëm. Pengesa dhe armiq të lirive dhe të drejtave të njeriut paraqiten edhe vetë qytetarët në marrëdhëniet e tyre reciproke. Në të vërtetë, sipas pikëpamjes liberale, shteti përfaqëson një "të keqe të domosdoshme", që duhet të kufizohet për shkak se, ata që ushtrojnë pushtetin shtetëror janë të prirur për keqpërdorim të tij në kurriz të individit. Shteti është, megjithatë, një bashkësi e domosdoshme që shërben për të braktisur gjendjen në të cilën njeriu për njeriun është një ujk, siç do të thoshte **Tomas Hobs**, krejt kjo me qëllim të krijimit të shoqërisë politike në të cilën sundon fuqia e ligjit, jo dhuna e pastër e brutale.

Niveli i tretë i mbrojtjes së individit, përmes lirive dhe të drejtave të njeriut, i referohet mbrojtjes nga të fuqishmit e ekonomisë. Kjo nevojë në thelb ndryshon konceptin klasik të lirive dhe të drejtave të njeriut,

[9] Michel Rosenfeld and Andras Sajo (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law* (Oxford University Press: Oxford, 2012), fq. 13-21 & 22-26.

në veçanti sa i përket të drejtave sociale dhe ekonomike. Një ndryshim i tillë ka ardhur si rrjedhojë e faktit që një pjesë e shteteve moderne i kanë lënë qytetarët në mëshirën e ligjshmërisë së ofertës dhe kërkesës për fuqi punëtore, konform ideologjisë së neoliberalizmit dhe ekonomisë së tregut. Pikërisht për këtë arsye, shteti normon vetëm kushtet minimale të punës, fitimet dhe investimet (dhëniet) sociale, duke lënë pjesën tjetër objekt marrëveshjeje në mes të punëdhënësve dhe punëtorëve, të cilët, në thelb, janë palët të pabarabarta kontraktuese. Qëllimi i veprimtarisë së shtetit të përgjegjshëm shoqërisht, apo **shtetit të mirëqenies**, siç quhet zakonisht, në të vërtetë, nuk është të mbrojë liritë dhe të drejtat e qytetarit nga shteti, por nga subjektet ekonomike, të cilat, në garën e tyre për fitim, ato liri dhe të drejta i rrezikojnë, i cungojnë dhe i zvogëlojnë. Shteti i mirëqenies, pikërisht për këtë arsye, duhet të reagojë me përparësi në drejtim të shmangies së gjendjes ku nënshtrimi ekonomik zhvlerëson dhe humb kuptimin e të drejtës për punë, fitim, pushim me pagesë, kompensim në rast të paaftësisë për punë, të drejtën për jetë, dinjitet, zhvillim të personalitetit, arsimim, planifikim të familjes dhe një numër tjetër të madh të lirive dhe të drejtave të njeriut.[10]

Mbi ekzistimin, realizimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut mund të bëhet fjalë vetëm nëse shteti është kushtetues dhe demokratik. Në këtë kuptim, shtet kushtetues është ai shtet në të cilin, në njërën anë, pushteti kufizohet me kushtetutë dhe, në anën tjetër, garantohen liritë dhe të drejtat themelore. Kushtetuta është simbol i lirisë së individit në një shtet që respekton liritë dhe të drejtat themelore, të cilat i gëzojnë të gjithë në mënyrë të barabartë. Në të njëjtën kohë, duke përfshirë në kushtetutë të gjitha liritë dhe të drejtat themelore, atyre normave kushtetuese iu njihet fuqia e normave me fuqi më të lartë juridike. Si shtet demokratik, ndërkaq, në kuptim të ekzistimit, realizimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, konsiderohet ai shtet në të cilin këto liri e të drejta të garantuara me kushtetutë kanë një cilësi (kualitet) të caktuar. Nuk mjafton vetëm ekzistimi i të drejtës kushtetuese për votë: ajo duhet të jetë e drejtë e përgjithshme, kurse fuqia e votës e barasvlershme për të gjithë; nuk mjafton proklamimi i lirisë së shtypit, fjala publike duhet të jetë e lirë; e drejta për gjykim të pavarur nuk do të thotë që mjafton që shteti të krijojë institucione të pushtetit që quhen gjykata: ato duhet të gjykojnë në bazë të kushtetutës dhe ligjit, dhe kështu me radhë.

Koncepti i lirive dhe të drejtave të njeriut ka mangësitë e veta, dy ndër të cilat janë më kryesoret. Mangësia e parë ka të bëjë me dallimin në mes të asaj që është e shkruar dhe asaj që realizohet në praktikë. Shtetet garantojnë liritë dhe të drejtat e njeriut duke ratifikuar marrëveshjet e caktuara ndërkombëtare, i fusin në kushtetuta nacionale, me efekt zbatimin e drejtpërdrejtë të tyre, i përpunojnë në mënyrë të detajuar me ligje, mirëpo me rastin e zbatimit të tyre në praktikë ekzistojnë kufizime të dukshme: nuk ka liri të shtypit, por **censurë**, ngushtohet dhe kriminalizohet liria e fjalës (me arsyetime të ndryshme), kufizohet liria e lëvizjes dhe kështu me radhë. Bazuar në kriterin e ekzistimit të lirive dhe të drejtave të njeriut, një shtet i tillë është kushtetues dhe demokratik vetëm formalisht, në sipërfaqe. Aspekti i dytë lidhet me mangësinë që e ka vërejtur **Hans Kelsen** (Hans Kelsen: 1881-1973),[11] por edhe **Karl Shmit** (Carl Schmitt: 1888-1985),[12] sa i përket natyrës së lirive dhe të drejtave të njeriut dhe mundësisë për zbatimin e tyre të drejtpërdrejtë përmes rrugëve gjyqësore dhe mekanizmave të tjerë juridikë. Kjo mangësi vë në

[10] Cf. më shumë në Katharine G. Young Constituting Economic and Social Rights (Oxford University Press: Oxford, 2012); Francisco Jorge Rodríguez Gonzálvez, "Exploring the Constitutional Possibilities for a European Social Model. Some Common Constitutional Traditions between Liberalism and Social Intervention". *L'Europe en Formation* Vol. 2 No. 372 (2014) fq. 122-151; August Thor Aranson, "Constitutionalism: Popular Legitimacy of the State?". Në Martin Scheinin (ed.), *Welfare State and Constitutionalism - Nordic Perspectives* (Nordic Council of Ministers: Copenhagen, 2001), fq. 29-78.

[11] Cf. më shumë në Véronique Champeil-Desplats, "Hans Kelsen's Works and the Modern Theories of Human Rights". Në Peter Langford, Ian Bryan, John McGarry (eds.), *Kelsenian Legal Science and the Nature of Law* (Springer: Cham, 2017) fq. 173-191.

[12] Cf. më shumë në William Rasch, "Human Rights as Geopolitics: Carl Schmitt and the Legal Form of American Supremacy" *Cultural Critique* No. 54 (Spring, 2003), fq. 120-147 (për dallim nga Hans Kelsen, ky autor, në fakt, ka qenë shumë armiqësor ndaj lirive dhe të drejtave të njeriut, jo vetëm sa i përket aspektit të realizimit të tyre përmes rrugëve gjyqësore dhe rrugëve të tjera juridike).

pah mundësinë e ideologjizimit dhe politizimit të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe përdorimin e tyre për qëllime të kundërta me atë për çka ekzistojnë ato si garancione kushtetuese e vlera ndërkombëtarisht të sanksionuara dhe të mbrojtura.

Në këtë materie të së drejtës kushtetuese, disa të drejta dhe liri emërtohen vetëm si të drejta e disa vetëm si liri. Kështu, ta zëmë, kemi të drejtën për jetë, dinjitet, pronësi private, punë etj., kurse liri të lëvizjes, shtypit (medies), mendimit, ndërgjegjes, fesë dhe kështu me radhë.

2. Burimet juridiko-politike mbi të drejtat e njeriut

Akteve juridike, si burime që rregullojnë liritë dhe të drejtat e njeriut, iu kanë parapri deklaratat mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, të cilat esencialisht kanë qenë akte politike. Në deklarata janë proklamuar liritë dhe të drejtat më të rëndësishme, në pajtim me ideologjinë që kanë pasur bartësit e ndryshimeve shoqërore, si hartues të tyre. Më pastaj, ato janë bartur në aktet juridike të shteteve - kushtetuta dhe ligje.

Konstitucionalizmi dyshekullor ka nisur me revolucionet nacionale me karakter borgjez, njëri krijoi **Shtetin amerikan** (1776), kurse tjetri ridefinoi rrënjësisht **Shtetin francez** (1791), duke ndryshuar rendin politik dhe juridik pararendës. Si pjesë e këtyre ndryshimeve revolucionare ka qenë edhe miratimi i deklaratave mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, më pastaj edhe i kushtetutave. Më shumë se dy shekuj më vonë, gjatë **Revolucionit të Tetorit** (1917), u ndryshua sistemi politik dhe juridik kapitalist dhe u miratua deklarata që ndryshoi vlerësimin e deriatëhershëm të lirive dhe të drejtave të njeriut. E kemi fjalën për **Deklaratën e Popullit Punues dhe të Eksploatuar**, e cila përmbysi botëkuptimin liberal – borgjez mbi liritë dhe të drejtat e njeriut që për fokus kishin individin, jo kolektivitetin.[13]

Edhe pse janë miratuar si akte nacionale, ndikimi i deklaratave ka qenë më i gjerë, thuajse global. Ato u kanë parapri kushtetutave. Në aspektin juridik dhe politik, rëndësia e tyre ka qenë historike, si për zhvillimin e të drejtave të njeriut ashtu edhe sa i përket zhvillimit të konstitucionalizmit në përgjithësi. Megjithatë, deklaratat nuk janë kushtetutë. Që nga fillimi janë konsideruar dokumente kushtetuese. Përmbajtja e deklaratave është bartur në kushtetutat nacionale, që janë miratuar më pastaj, si në SHBA ashtu edhe në Francë. Kjo është kështu sepse deklaratat përcaktojnë parimet e ndërtimit të shtetit: parimi i sovranitetit nacional, i ndarjes dhe balancimit të pushtetit, sundimi i punëtorëve dhe fshatarëve dhe i diktaturës së proletariatit e fshatarësisë (kur bëhet fjalë për eksperimentin komunist sovjetik, që dështoi në vitin 1990 pas mbarimit të Luftës së Ftohtë), garantimi i lirive dhe të drejtave të njeriut dhe kështu me radhë. Disa prej këtyre parimeve të mishëruara në deklaratat në fjalë, sot e kësaj dite janë norma kushtetuese në një pjesë bukur të madhe të vendeve. Me këtë qasje, deklaratat kanë krijuar hapësirë në dobi të konstitucionalizmit liberal, liberal-demokratik dhe socialist, në vartësi të ideologjisë që mishërohet në deklarata dhe kohës në të cilën ato janë shkruar.

Pas **Luftës së Dytë Botërore** miratohen deklaratat e konventat mbi liritë dhe të drejtat e njeriut në kuadër të **OKB**-së. Tani deklaratat me relevancë për liritë dhe të drejtat e njeriut miratohen si akte ndërkombëtare dhe si tekste të karakterit universal, me synim të përhapjes në pjesën më të madhe të vendeve të botës. Me këto akte mbi liritë dhe të drejtat e njeriut formalisht vërtetohet fakti se liritë dhe të drejtat e njeriut nuk janë vetëm çështje e brendshme e shteteve, por edhe kujdes i bashkësisë ndërkombëtare. Liritë dhe të drejtat e njeriut kanë natyrë universale, janë arritje civilizuese që i kanë përqafuar shtetet sepse u takojnë krejt qenieve njerëzore. Në këtë kuptim, mund të thuhet se e drejta natyrore me bazë racionale ka kaluar në planin ndërkombëtar, si themel për arsyetimin e përmbajtjes së akteve kryesore ndërkombëtare mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, me fillim që nga **Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut** (DUDNJ), miratuar më 10 dhjetor 1948 nga **Asambleja e Përgjithshme e OKB-së**.

---

[13] Declaration of Rights of the Working and Exploited People. 3 January, 1918. Në internet: https://www.marxists.org/archive/lenin/works/1918/jan/03.htm (shikuar në prill 2022).

Burim i normave ndërkombëtare mbi liritë dhe të drejtat e njeriut janë edhe deklaratat, konventat dhe instrumentet e organizatave regjionale (Këshilli i Evropës, Organizata e Shteteve Amerikane, Unioni Afrikan etj.), që janë shkruar për shtetet e një ose disa kontinenteve.

Krahas tyre ekzistojnë burime të normave ndërkombëtare mbi liritë dhe të drejtat e njeriut që kanë karakter universal dhe paraqiten jo vetëm në formë të deklaratave, por edhe të konventave dhe instrumenteve të tjera me karakter universal.

2.1. Deklaratat e para mbi liritë dhe të drejtat e njeriut

Nga periudha e revolucionit amerikan (lufta për pavarësi: 1765-1791), duhet të shkëputen për analizë **Deklarata e të Drejtave e Shtetit Virxhinia** e datës 12 qershor 1776 dhe **Deklarata e Pavarësisë** e datës 4 korrik 1776.

Deklarata e Shtetit Virxhinia proklamon qëllimet politike që konsistojnë në krijimin e një qeverie të pavarur e të përgjegjshme, me sovranitet popullor dhe ndarje të pushtetit. Pjesa më e madhe e saj, megjithatë, nuk bën fjalë për rregullimin e origjinës, organizimin dhe mënyrën e ushtrimit të pushtetit shtetëror, por për liritë dhe të drejtat e njeriut (nga gjithsejtë 16 nene sa i ka). Të gjithë njerëzit kanë të drejtë për ta gëzuar jetën dhe lirinë, të fitojnë dhe posedojnë pronë, të ndjekin lumturinë dhe sigurinë, shërbejnë si postulate nga e drejta natyrore që sanksionon Deklarata. Në mesin e të drejtave konkrete, ndërkaq, ajo proklamon lirinë e shtypit, lirinë e fesë, garanton lirinë personale përmes ndalimit të privimit nga liria përveç në bazë të ligjit dhe vendimit të porotës, të drejtën e mbrojtjes, barazinë e të gjithëve pa privilegje të trashëguara ose privilegje të tjera (nenet 4, 8, 12 dhe 16).

Pa u bërë një muaj, nga ana e trembëdhjetë shteteve, koloni të deriatëhershme britanike, miratuan **Deklaratën e Pavarësisë**. Ky dokument përqafon disa nga idetë e **Deklaratës** së **Virxhinias**, konfirmon arsyet dhe bazat e luftës kundër kurorës britanike (dhe "vëllezërve britanikë", të cilët i quan armiq në luftë e miq në paqe), parimet mbi të cilat do të mbështetet rregullimi i shtetit të ri dhe të drejtat me të cilat do të disponojë (lufta, paqja, tregtia, aleancat). Deklarata, megjithatë, nuk rregullon liritë dhe të drejtat konkrete. Si pikë nisëse ka premisën sipas së cilës krejt njerëzit lindin të barabartë dhe nga Krijuesi vishen me disa të drejta të patjetërsueshme, siç janë: e drejta për jetë, liri dhe synimi për të qenë i lumtur. Për t'i realizuar këto qëllime, njerëzit e lirë krijojnë shtete dhe organizojnë qeveri të drejtë. Nëse qeveria i tradhton qëllimet e synimet e tyre, duke u bërë shtypëse (si kurora britanike), atëherë ata mund të përmbysin atë dhe krijojnë një qeveri të re në shtetin e lirë dhe të pavarur.[14] Në të janë numëruar individualisht liritë dhe të drejtat e shkelura, si shembull negativ i arbitraritetit mbretëror, jo i sundimit të ligjit, shkelje që kanë shërbyer si motiv për sjelljen e deklaratës. Këtu bëhet fjalë për shkeljet si vijon: vënien e tatimit pa pëlqim popullor, suspendimin e të drejtës së votës, abrogimin e pavarësisë së gjyqeve dhe sulme të tjera në të drejta të njeriut.

Deklarata e të drejtave të njeriut dhe qytetarit është burimi më i rëndësishëm i lirive dhe të drejtave të njeriut në territorin e Evropës, me rëndësi universale: nën ndikimin e saj, siç e ka thënë **Xh. Jellinek**, të drejtat individuale janë kthyer në të drejta pozitive të vendeve evropiane.[15] Përfaqësuesit e kombit francez të kohës, në preambulë dhe shtatëmbëdhjetë nenet e saj kanë rregulluar liritë dhe të drejtat më të rëndësishme personale dhe politike, si dhe detyrimet. Subjekt i të drejtave dhe detyrimeve, në rend të parë është njeriu si qenie njerëzore, pastaj vjen njeriu si qytetar - bartës i të drejtave politike. Pika nisëse e Deklaratës është se njerëzit lindin dhe ngelin të lirë në të drejta (neni 1). Më pas numërohen ruajtja e lirisë, pronës, sigurisë dhe rezistenca ndaj shtypjes, si qëllime e synime të çdo bashkimi politik (neni 2). Deklarata thekson sovranitetin popullor, definon lirinë, ligjin

[14] Për komentet e kësaj teme, cf. në Aleksandar Molnar, *Rasprava o demokratskoj ustavnoj državi. 2. Klasične revolucije: Nizozemska, Engleska, SAD* (Samizdat B92: Beograd, 2001), fq. 341-438.

[15] Georg Jellinek, *The Declaration of the Rights of Men and Citizens*, fq. 2.

si shprehje të vullnetit të përgjithshëm, përmban parimin e legalitetit të veprës dhe sanksionit penal, prezumimin e pafajësisë, lejon çdo veprim përveç atyre që ndalohen shprehimisht me ligj (nenet 3-9). Garantohet liria e mendimit dhe bindjeve, fjalës, fesë, kurse e drejta në pronë private shpallet si e pacenueshme dhe e shenjtë (nenet 10, 11 dhe 17). Futet detyrimi i kontributit publik (tatimit), me qëllim të mirëmbajtjes së fuqisë publike dhe administratës (nenet 12-15). Nëse këto të drejta nuk sigurohen dhe pushteti shtetëror nuk është i ndarë, as që mund të bëhet fjalë për kushtetutë (neni 16). Dy vite më pas është nxjerrë edhe **Deklarata e të drejtave të gruas dhe qytetares** (1791), në të cilën si subjekte të lirive dhe të drejtave dhe detyrimeve figurojnë gratë, njëjtë si burrat (pavarësisht ose krahas burrave), kurse janë ndryshuar krejtësisht disa dispozita të Deklaratës së vitit 1789 (nenet 11-13 dhe 17).[16]

Në vijim si më sipër, në kontekstin francez, vlen të trajtohet edhe Deklarata e vitit 1793, e cila ka më shumë karakter egalitar (populllor) dhe mishëron në formë të shkruar parimet revolucionare jakobine.[17] Krahas lirive dhe të drejtave nga Deklarata e vitit 1789, ky dokument ka qenë pionier i promovimit të lirive dhe të drejtave të gjeneratës së dytë, përkatësisht lirive dhe të drejtave sociale, ekonomike dhe arsimore. Shoqëria duhet të ofrojë siguri dhe mbrojtje për secilin anëtar të saj, ndihma shoqërore ndaj të varfërve është një detyrim i shenjtë, arsimimi u nevojitet të gjithëve (nenet 8, 21 dhe 22).

Deklarata e Popullit Punues dhe të Eksploatuar është nxjerrë nga rusët sovjetikë dhe shërben si platformë që shpreh hegjemoninë ruse pas rrënimit të **dinastisë Romanov** në **Revolucionin e Tetorit** (1917) me synim rikthimin e fuqisë së humbur ruse dhe dominimin ndaj popujve jorus, përmes përdorimit të ideologjisë në dukje universale dhe klasore, jonacionale dhe joruse. Kongresi i tretë i Sovjetit të Rusisë,[18] më 12 janar 1918 e fut këtë dokument në **Kushtetutën e Rusisë Sovjetike** të vitit 1918. Si e tillë, Deklarata ka pasur shumë ndikim në zhvillimin e lirive dhe të drejtave të njeriut sipas konceptit komunist, me të cilin u mbështjell ideologjia nacionaliste dhe hegjemoniste e **Rusisë** post-revolucionare. Fokusi i këtij dokumenti ka qenë kryesisht në promovimin e lirive dhe të drejtave kolektive mbi bazën e ideologjisë krejtësisht joliberale - ideologjisë bolshevike komuniste mbi organizimin e shoqërisë.[19] Populli punues dhe i eksploatuar shfaqet si një klasë e re në shtetin "e punëtorëve dhe fshatarëve", i cili bëhet pronar i mjeteve të prodhimit. Ky shtet eliminon pronën private ndaj tokës, fut detyrimin e përgjithshëm për punë, kontrollin punëtor ndaj ekonomisë, armatosjen e punëtorëve (që ndërtuan **Armatën e Kuqe**, forcën ushtarake që do të bëhet mëpastaj, deri në fundin e komunizmit, më 1990, një simbol i terrorit shtetëror dhe dhunës ndaj popujve të tjerë jorus) dhe çarmatosjen e njerëzve të pasur. Deklarata ka qenë themeli ideologjik i zhvillimit të konstitucionalizmit komunist që ka dominuar një pjesë bukur të madhe të shteteve të botës, përfshirë Evropën, deri në fund të viteve '80-të të shekullit të kaluar, konstitucionalizëm që është bazuar në rolin avangard të partisë komuniste, parimin e unitetit të pushtetit dhe sistemin e kuvendeve, të drejtat kolektive (kryesisht të natyrës socio-ekonomike) që i nënshtrohen interesit sublim të shtetit socialist, mungesën e të drejtave civile dhe politike dhe dhunën e terrorit shtetëror për ruajtjen e bazës kushtetuese të shtetit në fjalë.

---

[16] Déclaration des droits de la femme et de la citoyenne, 1791. Autore e saj ka qenë dramaturgja e aktivistja politike për të drejtat e grave, Olimp de Guzh (Olympe de Gouges: 1847-1793). Në internet: https://gallica.bnf.Fr/essentiels /anthologie/declaration-droits-femme-citoyenne-0 (shikuar në prill 2022).

[17] Është miratuar më 10 gusht 1793 dhe ka shërbyer si njëri prej seksioneve të **Kushtetutës së Francës** që u shpall më 24 qershor 1793, kurse ishte miratuar në referendum së bashku me Deklaratën. Kushtetuta kurrë nuk gjeti zbatim dhe u zhvesh nga fuqia e saj juridike menjëherë. Për tekstin e Deklaratës së vitit 1793, cf. **Déclaration des droits de l'homme et du citoyen de 1793**. Në internet: https://www.lexilogos.com/ declaration/droits_homme_1793.htm (shikuar në prill 2022).

[18] Kongresi i sovjetëve ka qenë organ përfaqësues dhe pushtet suprem që ka udhëhequr shtetin e diktaturës së proletariatit në ish-**BRSS** ("Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike") dhe shtetet e tij anëtare; u themelua si organ revolucionar komunist i **Rusisë** post-revolucionare, më pastaj me dhunë u përhap nëpër vendet tjera joruse, përfshirë Evropën ish-komuniste pas vitit 1945.

[19] Cf. më shumë në artikullin e shkëlqyer të Michael V. Kryukov, "Self-determination from Marx to Mao". Ethnic and Racial Studies Vol. 19 No. 2 (April 1996), fq. 352-378.

2.2. Aktet e mëvonshme ndërkombëtare mbi liritë dhe të drejtat e njeriut

Procesi i **ndërkombëtarizimit** të lirive dhe të drejtave të njeriut, i filluar pas **Luftës së Parë Botërore**, merr hov pas tragjedisë së **Luftës së Dytë Botërore**, në të cilën ndodhi shkelja masive brutale e lirive dhe të drejtave të njeriut, deri në gjenocid ndaj hebrenjve dhe popujve të tjerë që nazistët i shihnin si të padenjë për të ekzistuar. Motivi parësor për miratimin e **Kartës së OKB-së** në vitin 1945 ka qenë pikërisht që të shpëtohen gjeneratat e ardhshme nga tmerret e luftës dhe të rikthehet besimi në të drejtat themelore të njeriut, në dinjitetin dhe vlerën e personit njerëzor, barazinë e burrave dhe grave, kombeve të mëdha e të vogla. Karta nuk përmban liri dhe të drejta konkrete, por fton për respektimin e përgjithshëm të tyre, pa dallime në racë, gjini, gjuhë, fe, etj.

Është një tjetër akt juridik-ndërkombëtar që përmban liri dhe të drejta konkrete - **DUDNJ**. Ky dokument shërben si një standard për krejt popujt dhe shtetet. Ky standard, megjithatë, paraqitet si shumë abstrakt, i lartë dhe i përgjithësuar. Kjo ka bërë që Deklarata mos të jetë një burim formal i së drejtës, me përjashtim të atyre vendeve që ia kanë njohur një status të tillë në rendin e brendshëm kushtetues, përfshirë **Kosovën**. Pikërisht për këtë, nuk ka pasur nevojë që të ratifikohet e as të vihet si detyrim për futjen e saj në rendin e brendshëm të shteteve anëtare të **OKB-së** dhe shteteve të tjera. Sipas saj, qeniet njerëzore janë të lira dhe të barabarta në të drejta. Të gjithë, pa asnjë diskriminim, gëzojnë të drejtat vetjake, si vijon: të drejtën për jetë, liri, siguri personale, personalitet, mbrojtje të barabartë para ligjit, gjykim të drejtë, liri të lëvizjes, zgjedhje të vendbanimit, të drejtën në azil, shtetësi, lidhje të martesës, pasuri, liri të mendimit, ndërgjegjes dhe fesë (nenet 1-19); pastaj të drejtat politike: e drejta për asociim dhe tubim, e drejta e votës, marrjes pjesë në udhëheqjen me vendin (nenet 20-21); të drejtat socio-ekonomike: e drejta në sigurimin social, punë, rrogë, mbrojtjen nga papunësia, pushim dhe argëtim, standard jetësor, shkollim, pjesëmarrje në jetën kulturore dhe përparimin shkencor, si dhe e drejta në shoqëri në të cilën krejt këto liri dhe të drejta mund të realizohen (nenet 22-28). Kufizimet e lirive dhe të drejtave të njeriut, sipas Deklaratës, mund të bëhen vetëm me ligj dhe me qëllim të respektimit të të drejtave dhe lirive të tjerëve e për arsye të mbrojtjes së moralit, rendit publik dhe mirëqenies së përgjithshme në një shoqëri demokratike.

Dy pakte ndërkombëtare në mënyrë të detajuar përpunojnë dispozitat e **DUDNJ-së**, duke marrë më shumë parasysh mundësitë reale për realizmin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Me to normohen të drejtat e individit dhe të drejtat kolektive dhe, për dallim nga Deklarata Universale, përbëjnë burim të së drejtës. E kemi fjalën për **Paktin për të Drejtat Civile dhe Politike** (PDCP: 1966) dhe **Paktin për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore** (PESK: 1996).

PDCP-ja është miratuar më 16 dhjetor 1966 dhe ka hyrë në fuqi më 1975. Shtetet që e kanë ratifikuar detyrohen për respektim të të drejtave të burrave, grave dhe fëmijëve. Pas hyrjes (preambulës), ku thirret në **Kartën e OKB-së** dhe **Deklaratën Universale**, **PDCP-ja** ua garanton popujve të drejtën për vetëvendosje (neni 1). Të **drejtat personale** fillojnë me të drejtat përmes së cilave mbrohen: integriteti fizik dhe psikik (e drejta për jetë, ndalimi i torturës, trajtimit johuman dhe *çnjerëzor*, etj., nenet 6-8), liria dhe siguria e personalitetit (e drejta për liri dhe siguri, ndalimi i robërisë, robërisë së borxheve etj., nenet 9-11), gjykimi i drejtë dhe i paanshëm (nenet 14-16). Këto pasohen nga mbrojtja e **lirive personale** si vijon: lirisë së lëvizjes, mendimit, ndërgjegjes, fesë dhe besimit dhe të drejtës për privatësi (nenet 12, 13 dhe 17-24). Me PDCP ndalohet propaganda e luftës, përhapja e urrejtjes dhe diskriminimi (nenet 20 dhe 26) dhe mbrohen të drejtat e pakicave kombëtare (neni 27).

Nga të **drejtat politike**, përveç të drejtës kolektive të popujve për vetëvendosje, **PDCP-ja** njeh edhe lirinë e shprehjes së mendimeve, të drejtën e tubimit paqësor dhe asociimit, përfshirë përcaktimin e arsyeve për kufizimin e tyre (siguria shtetërore, rendi publik, të drejtat e të tjerëve, morali), të drejtën aktive dhe pasive zgjedhore, të drejtën për shërbimin dhe pjesëmarrje në punët publike (nenet 19, 21, 22 dhe 25).

Me **PDCP-në** themelohet **Komiteti për të Drejtat e Njeriut**, të cilit i kushtohen 18 nene dhe i cili studion raportet e shteteve mbi masat e ndërmarra për zbatimin e Paktit dhe konstaton nëse shtetet po i respektojnë liritë dhe të drejtat njerëzore. Komiteti, si dhe komisioni i tij për pajtim të shteteve, nuk kanë autorizime ekzekutive – nuk mund të dënoj shtetin, as ta detyroj për të ndërmarrë ndonjë masë me qëllim të respektimit të lirive dhe të drejtave të garantuara. Krahas **PDCP-së** ekzistojnë protokollet shtesë, të cilave mund t'ju bashkohen shtetet palë të tij. Ekzistojnë dy sosh dhe janë opsionale, njëri nga vitit 1966 dhe tjetri nga vitit 1989. I pari krijon **mekanizmat ankimorë** në dispozicion të individit me qëllim të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave njerëzore, kurse i dyti **abrogon dënimin me vdekje**, me mundësinë që të mbahet përjashtimisht për vepra jashtëzakonisht të rënda penale. Fuqia e këtyre dy protokolleve shtrihet vetëm ndaj shteteve që i kanë ratifikuar apo kanë aderuar në to më pastaj.

PDESK-ja është miratuar më 16 dhjetor 1966, kurse ka hyrë në fuqi në vitin 1976. Ka të njëjtën hyrje (preambulë) dhe dispozita të njëjta fillestare (neni 1: e drejta e popullit për vetëvendosje) sikur edhe **PDCP-ja**. Shtetet palë zotohen se do të marrin masat e duhura me qëllim të realizimit të lirive dhe të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore të burrave, grave dhe fëmijëve (nenet 2-5). Kjo nuk varet vetëm nga vullneti i shteteve palë, por edhe nga mjetet në dispozicion, pasurisë shtetërore që duhet maksimalisht të përdoret për realizimin e këtyre të drejtave. Pas kësaj pasojnë të drejtat konkrete: e drejta në punë dhe të drejtat që derivojnë nga ajo (kushtet e punës, pagesa, pushimi), sigurimi social, mbrojtja e familjes, me kuptim edhe arritjen e një standardi përkatës për zhvillim të familjes (ushqimi, veshmbathja, banimi), e drejta në shëndet, arsimim (shkollimi fillor është pa pagesë dhe i detyrueshëm), pjesëmarrja në jetën kulturore (nenet 6-15). Mbi masat e ndërmarra për realizimin e këtyre të drejtave, shtetet paraqesin raport vjetor, të cilat i shqyrton **Këshilli Ekonomiko-Social** i OKB-së. Me protokollin opsional të vitit 2008, shtetet palë pranojnë kompetencën e **Komitetit për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore** për ta përcjellë zbatimin e **PDESK-së** dhe për këtë të bëjnë raport pesëvjeçar. As ky Komitet nuk ka autorizime ekzekutive, por shteteve mund t'iu dërgojë rekomandime të padetyrueshme ligjërisht lidhur me nivelin e zbatimit të **PDESK-së**. Komiteti mund të konstatojë cenimin e dispozitave të **PDESK-së** në procedurat që kanë të bëjnë me sa vijon: parashtresat individuale, parashtresat shtetërore dhe hetimet, gjë që mund të shpie në sanksione të caktuara të natyrës politike dhe etike, por jo edhe juridike.

Për aspekte të lirive dhe të drejtave të njeriut janë miratuar konventa të posaçme, nën kulmin e OKB-së. Janë shumë në numër, ashtu që ne po veçojmë vetëm disa prej tyre që janë më me rëndësi: **Konventa për pengimin dhe ndëshkimin e krimit të gjenocidit** (1948); **Konventa për realizimin e kërkesave për alimentacion në botën e jashtme** (1954); **Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor** (1965); **Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave** (1979); **Konventa kundër torturës dhe ndëshkimeve e veprimeve të tjera mizore, çnjerëzore dhe degraduese** (1984); **Konventa për të drejtat e fëmijëve** (1989); **Konventa për të drejtat e personave me invaliditet** (2006); **Konventa për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukja e dhunshme** (2007) etj. Një pjesë e dokumenteve të sipërcekura ndërkombëtare janë pjesë e sistemit kushtetues të **Kosovës** dhe zbatohen drejtpërdrejtë nëse kanë dispozita të vetekzekutueshme. Në vendet tjera përreth **Kosovë**s, kjo nuk është kështu: këto dokumente si dhe ato të nivelit evropian që pasojnë, janë bërë pjesë e sistemeve juridike të fqinjëve kosovar përmes internalizimit të tyre në bazë të rregullave kushtetuese mbi ratifikimin. Këto dokumente dhe të tjerat që rregullojnë sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut, kur mishërojnë standarde ndërkombëtare përgjithësisht të pranuara, gëzojnë fuqi më të lartë juridike se çdo ligj tjetër nacional, nganjëherë kanë vlerë kushtetuese (veçanërisht kur bëhet fjalë për nivelin evropian të konventave dhe dokumenteve që duhet të shërbejnë si udhëzues për rrugëtim drejt anëtarësimit në BE).

Në truallin evropian, pra, konventat dhe dokumentet tjera në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut kanë pozitë dhe rol tjetër në sistemet nacionale të vendeve anëtare të KE-së dhe BE-së. Më e rëndësishmja ndër to është **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut** (KEDNJ) e vitit 1950. Kjo Konventë fuqishëm mbështetet në **DUDNJ** dhe përcakton detyrimin e shteteve palë që të respektojnë liritë dhe

të drejtat e garantuara me të. Rëndësia e saj e veçantë qëndron në atë se vendos një mekanizëm për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të garantuara aty. Ai mekanizëm quhet **Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut** (GJEDNJ) dhe e ka selinë në Strasburg. Individi me kërkesë individuale mund t'i drejtohet kësaj Gjykate, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të cenuara nga shteti nën juridiksionin e të cilit gjendet individi, pra kundër shtetit të vet. Të tilla janë, ta zëmë, kërkesat që pohojnë cenimin e të drejtës për barazi, diskriminim, gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe kështu me radhë. Kur fiton kontestin, individi fiton një vendim që ka cilësinë e aktgjykimit të detyrueshëm për shtetin vetjak, si palë e paditur, i cili duhet ta vejë në jetë duke bërë kompensimin e dëmit të shkaktuar, në rend të parë përmes rikthimit në vend të lirisë dhe të drejtës së cenuar, por edhe përmes rrugëve të tjera juridike të identifikuara nga GJEDNJ-ja me vendimin e saj në dobi të individit e kundër shtetit konkret.

Në pjesën e parë të KEDNJ-së normohen: e drejta për jetë, ndalohet tortura, skllavëria dhe puna e detyruar, e drejta për liri dhe siguri, e drejta për gjykim të drejtë e të paanshëm, parimi legalitetit të sanksionit dhe veprës penale, e drejta për jetë private dhe familjare, liria e mendimit, ndërgjegjes, fesë dhe besimit dhe e shprehjes së mendimit, liria e tubimit dhe asociimit, e drejta për lidhje të martesës, e drejta për mjet efektiv juridik, ndalimi i diskriminimit dhe keqpërdorimit të së drejtës. Nga e drejta për jetë, ndalimi torturës, skllavërisë, punës së detyruar dhe parimi legalitetit nuk mund të ketë shmangie as në kohë të gjendjes së jashtëzakonshme. Këto janë të drejta të mbrojtura në mënyrë absolute. Në kohë lufte apo rrezikut tjetër publik që i kërcënohet ekzistencës së shtetit, të drejtat tjera mund të kufizohen vetëm në masën që është e domosdoshme në një shoqëri demokratike, duke ndjekur një qëllim legjitim dhe në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe në mënyrë proporcionale, duke mos cenuar thelbin e të drejtës së garantuar. Me KEDNJ normohen aspektet kryesore lidhur me GJEDNJ, siç janë: themelimi, zgjedhja e gjyqtarëve, organizimi i brendshëm, kompetenca, procedura dhe gjykimi.

Nga konventat dhe kartat e posaçme evropiane vlen të përmenden: Karta Sociale Evropiane (KSE), e miratuar nga Këshilli Evropës (KE) në vitin 1961, e cila përcakton, në mes tjerash, që çdokujt duhet t'i jepet mundësia për të fituar për jetë me kryerjen e punës që lirisht e ka zgjedhur (pjesa I, neni 1); Konventa Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale, e miratuar nga KE në vitin 1985, me të cilën rregullohen të drejtat dhe detyrat e organeve të pushtetit lokal; Konventa mbi pengimin e torturës dhe ndëshkimeve e veprimeve të tjera **mizore, çnjerëzore dhe degraduese**, miratuar nga KE në vitin 1987, me të cilën formohet një komitet me të njëjtin emër; Karta evropiane mbi gjuhët regjionale dhe të pakicave, miratuar nga **KE** në vitin 1992, që i pranon gjuhët regjionale dhe të pakicave si pasuri kulturore (neni 7); **Konventa kuadër për mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare**, miratuar nga **KE** në vitin 1994, me të cilën pakicave u garantohet barazia para ligjit dhe mbrojtja e njëjtë ligjore (neni 4).

2.3. Liritë dhe të drejtat e njeriut në kushtetutë

Aktet ndërkombëtare mbi liritë dhe të drejtat e njeriut i kanë ratifikuar një numër i madh i shteteve, përkatësisht numri më i madh i shteteve të botës së sotme. Me këto akte, liritë dhe të drejtat e njeriut normohen në një mënyrë të detajuar, thuajse gjithëpërfshirëse. Me ratifikim, ato bëhen pjesë e të drejtës nacionale pozitive dhe fitojnë fuqinë detyruese. Çështja që shtrohet këtu është se cilat prej lirive dhe të drejtave të normuara me akte ndërkombëtare duhet të futen në kushtetutë dhe, për pasojë, të fitojnë fuqinë më të lartë juridike? Të rralla janë vendet si **Kosova** e **Bosnje-Hercegovina** që aktet kryesore ndërkombëtare i fusin në kushtetutë në mënyrë të njëanshme, duke i bërë norma kushtetuese me zbatim të drejtpërdrejtë në rendin e brendshëm juridik.

Liritë dhe të drejtat e njeriut janë pjesë përbërëse e kushtetutës. Në këtë kuptim, sipas materies që kryesisht normohet me kushtetutë, në historinë kushtetuese krahasimore mund të dallohen dy lloje të normimeve kushtetuese: **kushtetutat sociale**, thënë kushtimisht, me të cilat nënkuptohen normimet në kushtetuta që përcaktojnë liritë dhe të drejtat e qytetarëve, përkatësisht rolin dhe pozitën e individit në shoqëri dhe **kushtetutat politike**, thënë kushtimit, me të cilat nënkuptohen normimet në kushtetuta që

kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionimin e pushtetit shtetëror, që përcaktojnë rolin dhe pozitën e organeve të pushtetit.[20] Një kohë të gjatë, kushtetutat kanë normuar vetëm aspektin politik të organizimit të shtetit. Vërehet tani se në kushtetutat bashkëkohore të vendeve demokratike, synohet që sa më imtësisht të normohet materia e lirive dhe të drejtave të njeriut. Kjo përkundër faktit që shtetet, përmes marrëveshjeve dhe akteve të tjera juridike-ndërkombëtare, përqafojnë dispozita të njëjta që gjenden edhe në kushtetutat e tyre. Kjo bën që të ndodh dyfishimi i normave mbi liritë dhe të drejtat e njeriut në aktet të ndryshme të karakterit vendor (kushtetuta, ligje dhe akte të tjera të karakterit të brendshëm) dhe ndërkombëtar (marrëveshje të ratifikuara dhe akte të tjera juridike me karakter ndërkombëtar). Pengimi i dyfishimit mund të tejkalohet nëse me kushtetutë normohen vetëm parimet themelore mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, përkatësisht garancitë, kufizimet dhe mbrojtja e tyre. Në nivel të lirive dhe të drejtave konkrete, me qëllim pengimin e dyfishimit në normim, me kushtetutë do të mund të rregulloheshin ashtu që do të sanksionoheshin vetëm ato liri dhe të drejta që kanë karakteristika të veçanta që lidhen me kushtet e shtetit përkatës, në ndërkohë që drejtat e liritë tjera standarde personale, politike, sociale, ekonomike, kulturore dhe të tjera do të përshkruheshin në kushtetutë atëherë kur përmbajtja e tyre dallon në raport me përmbajtjen që kanë në burimet e pranuara ndërkombëtare (ta zëmë, dallimet sa i takon arsyeve të kufizimit).

Në kushtetuta, liritë dhe të drejtat e njeriut janë rregulluar në mënyrë të ndryshme. Kushtetutat e para të shkruara nuk kanë pasur dispozita mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, por vetëm norma mbi rregullimin e pushtetit. **Kushtetuta e SHBA-ve** (1787) shumë shpejt, në vitin 1791, është plotësuar me dhjetë amendamente të reja, të cilat së bashku quhen **Bill of Rights** ("Ligji i të Drejtave"), sipas modelit të vjetër britanik të vitit 1689 me të njëjtin emër. Me këtë qasje, materia e lirive dhe të drejtave të njeriut ka ngelur jashtë tekstit integral të Kushtetutës amerikane.

Në historinë kushtetuese të konstitucionalizmit francez, liritë dhe të drejtat e njeriut nuk kanë qenë tradicionalisht në kuadër të tekstit kryesor kushtetues, por janë rregulluar me deklarata mbi të drejtat. Deklarata e vitit 1789, si dokument kushtetues që normon liritë dhe të drejtat e njeriut, është pjesë e preambulave të dy kushtetutave të fundit franceze. Kushtetuta e vitit 1946 e ka futur Deklaratën e vitit 1789 në preambulën e saj dhe, njëkohësisht, në të njëjtin vend ka zgjeruar materien e lirive dhe të drejtave të njeriut. Kushtetuta e vitit 1958, aktualisht në fuqi, në preambulën e saj fton popullin francez që të deklarojë në mënyrë solemne besnikërinë ndaj të drejtave dhe parimeve të përcaktuar me Deklaratën e vitit 1789 dhe preambulën e kushtetutës pararendëse, duke lënë kësisoj jashtë pjesës operative liritë dhe të drejtat e njeriut. Vlen të theksohet se edhe në konstitucionalizmin bashkëkohor, liritë dhe të drejtat e njeriut mund të normohen me kartë apo dokument tjetër të posaçëm, pra nuk bëhet fjalë për vetëm për një specifikë të kushtetutave të vjetra. Kështu ta zëmë, **Karta çeke mbi të drejtat fundamentale dhe liritë themelore** i ka paraprirë **Kushtetutës së Çekisë** të vitit 1992.

---

[20] Në **kushtetutë politike** përfshihet regjimi shtetëror, në të cilin hyn jo vetëm shteti por edhe institucionet tjera brenda kombit. Ky regjim definohet si regjim civil që bazohet në pronën private dhe në transaksionin e lirë, në subordinimin e ushtrisë nga forcat civile, nënshtrimin e kishës ndaj pushtetit publik, i cili garanton të drejtat individuale dhe i mundëson individit të shfrytëzoj të mirat e shërbimit publik. Më këtë shihet se regjimi shtetëror nuk është shteti, ani se ai përfshihet aty, por një rend juridik dhe politik që ka shumë përbërës (subjekte) dhe marrëdhënie të nduarnduarshme, cilësi themelore e së cilës është ndarja e sferës publike nga sfera private.Në **kushtetutën sociale**, ndërkaq, përfshihet jo vetëm shteti si "institucioni i institucioneve", kushtetuta e tij politike, por mbi të gjitha dhe në rend të parë liritë individuale, liritë publike dhe institucionet shoqërore spontane. Këto operojnë dhe marrin jetë brenda hapësirës së krijuar me kushtetutën politike, përkatësisht përmes regjimit shtetëror. Cf. Cf. William H. Harbold, "Book Reviews: Précis de Droit Constitutionnel. By MAURICE HAURIOU. (Paris: Centre National de la Recherche Scientifique, Ministère de l'Education Nationale, 1965. Pp. xv, 759. 25F.); Droit Constitutionnel et Institutions Politiques. By ANDRÉ HAURIOU. (Paris: Editions Montchréstien, 1966. Pp. iv, 826.)". *Political Research Quarterly* Vol. 19 Issue 2 (1966) fq. 391-392; Norbert Foulquier, "Maurice Hauriou, constitutionnaliste (1856-1929)". *Jus Politicum. Revue internationale de droit politique* No. 2 (2009), fq. 1-31. Në internet: http://juspoliticum.com/article/Maurice-Hauriou-constitutionnaliste-1856-1929-75.html (shikuar në prill 2022); Julien Barroche, "Maurice Hauriou (1856–1929)". Në Oliver Descamps & Rafael Domingo (eds.), *Great Christian Jurists in French History* (Cambrdge University Press: Cambridge: 2019) fq. 342-357) në fq. 350-354.

Vendet që nuk kanë një **kushtetutë të kodifikuar** i rregullojnë liritë dhe të drejtat e njeriut me akte të posaçme që kanë fuqinë e kushtetutës ose të ligjit organik. Kështu, në historinë kushtetuese britanike ekzistojnë një mori aktesh kushtetuese që konsiderohen kushtetutë dhe normojnë liritë dhe të drejtat e njeriut, me fillim që nga **Karta e Madhe e Lirive** ("Magna Carta Libertatum": 1215), aktet e vitit 1628 ("Petion of Rights Act"/**Ligji për të Drejtat**) dhe 1689 ("Instrument of Governemnt: **Instrumenti i Qeverisjes**), si më të rëndësishme në këtë sferë, e deri te akti i vitit 1998 mbi përfshirja e normave të **KEDNJ-së** në sistemin kushtetues britanik ("Human Rights Act"/Ligji mbi të drejtat e njeriut). Ngjashëm është edhe me **Izraelin**, një vend tjetër që ndikohet fuqishëm nga sistemi kushtetues britanik, ku liritë dhe të drejtat e njeriut rregullohen me akte të posaçme, si p.sh.: **Ligji themelor mbi dinjitetin njerëzor dhe lirinë** (1992), **Ligji themelor mbi lirinë e profesionit** (1994) etj.

Ne kushtetutat që përmbajnë dispozita mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, ato mjaft shpesh figurojnë në kapituj të veçantë. Si të tilla, dispozitat në fjalë zakonisht gjenden të vendosura në pjesën pas dispozitave themelore dhe shumë më rrallë, në pjesën e dytë të kushtetutës, pas dispozitave mbi organizimin e pushtetit. Liritë dhe të drejtat njerëzore që janë të ngjashme mes veti grupohen në një vend, kurse mund të ndahen në kapituj dhe seksione të veçanta, si p.sh.: liritë dhe të drejtat personale, liritë dhe të drejtat politike, liritë dhe të drejtat sociale, ekonomike dhe kulturore, të drejtat e të huajve, liritë dhe të drejtat shtesë për pakicat kombëtare, detyrat e qytetarëve. Kushtetutat gjithashtu përmbajnë dispozita parimore mbi zbatimin, kufizimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave kushtetuese.

3. Ndarja e lirive dhe të drejtave të njeriut

Liritë dhe të drejtat e njeriut përcaktojnë pozitën juridike apo statusin (vendin) e qytetarit në shtet. Ato përcaktojnë marrëdhënien e individit me shtetin, në njërën anë, dhe, në anën tjetër, marrëdhënien e individëve në mes tyre. Individi gëzon disa të drejta edhe si anëtar i një grupi shoqëror apo kolektiviteti. Këto përcaktime bëjnë që liritë dhe të drejtat e njeriut të ndahen në disa grupe, sipas kritereve të ndryshme. Ndarjen e parë dhe më të rëndësishme, që sot e kësaj dite shkëlqen me ndikimin e saj, e ka bërë **Xhorxh Jellinek**. Sipas tij, e drejta është pushtet i vullnetit të individit, që është në shërbim të një interesi juridikisht të mbrojtur; në raport me pushtetin publik, individi nuk është bartës i një vullneti pa vlerë, por i një morie interesash konkrete që juridikisht rrinë përballë interesit publik. Nisur nga kjo, autori ka krijuar kategorinë e të **drejtave subjektive publike**, marrëdhënia e të cilave me pushtetin publik konceptohet si një marrëdhënie krejtësisht juridike, pra që nuk varet nga mëshira e pushtetit publik, por nga sundimi i normave juridikisht të detyrueshme të së drejtës pozitive.[21]

Sipas rolit që kanë qytetarët në shtet dhe anasjelltas, sipas rolit që shteti ka ndaj tyre, ekzistojnë **liritë dhe të drejtat e statusit aktiv** dhe **liritë dhe të drejtat e statusit pasiv**.[22] Në grupin e parë hyjnë ato që i mundësojnë qytetarëve të marrin pjesë në konstituimin e organeve të pushtetit ("të drejtat në"). Veprimi i qytetarëve përmes këtyre të drejtave është brenda sferës juridiko-publike. Të tilla janë, ta zëmë, të drejtat zgjedhore, e drejta e organizimit politik, shprehja e mendimit politik dhe liria e shtypit. Me ndihmën e këtyre të drejtave qytetarët janë aktivë në formimin dhe mirëmbajtjen e pushtetit demokratik. Në këtë kategori do të mund të futeshin edhe detyrimet e qytetarëve, të cilat në të vërtetë janë aktivitetet e tyre të domosdoshme për ruajtjen e mbijetesës dhe veprimtarisë së shtetit: pagimi i tatimeve, mbrojtja e shtetit, respektimi i ligjeve dhe të tjera si këtu.

Me **liritë dhe të drejtat e statusit pasiv**, ndërkaq, mbrohet sfera personale dhe private e individit kundrejt shtetit. Qëllimi i tyre nuk është të ndihmojnë aktivitetin e qytetarit kundrejt shtetit, siç bëjnë liritë dhe të drejtat e grupit të parë. Këto bëjnë të kundërtën - mbrojnë qytetarin kundrejt shtetit ("liritë nga" ose "liritë prej"). Në këto liri dhe të drejta "mbrojtëse", që nënkuptojnë vetëpërmbajtjen e shtetit, hyjnë,

[21] Olivier Jouanjan, "Historie de la science du droit constitutionnel". Në Michel Troper et Dominique Chagnollaud (eds.), *Traite international de droit constitutionnel*. Tome 1: Theorie de la Constitution (Dalloz: Paris, 2012) fq. 69-111 në fq. 90.

[22] Robert Alexy, *A Theory of Constitutional Rights* (Oxford University Press: Oxford, 2010), fq.163-177.

ta zëmë: paprekshmëria e banesës, fshehtësia e korrespondencës), liria e mendimit, fesë dhe ndërgjegjes, e drejta në dinjitet, integriteti fizik dhe psikik.

E ngjashëm më ndarjen si më sipër, gjithnjë sipas **Xh. Jellinek**, është ajo që ndan liritë dhe të drejtat në **liri dhe të drejta të statusit pozitiv** dhe **liri e të drejta të statusit negativ**.[23] Në **të drejta të statusit pozitiv** llogariten ato të drejta që, në fakt, përfaqësojnë detyrime për shtetin për të bërë diçka, për të ndërmarrë ndonjë veprim. Këto të drejta nuk mund të realizohen pa aktivitetin e shtetit, i cili, në praktikë, merr detyrim me kushtetutë për një gjë të tillë. Në këto të drejta hyjnë, ta zëmë, e drejta për arsim (shteti është i detyruar të themeloj dhe pajis shkollat, të draftojë programet dhe paguaj arsimtarët), e drejta në mbrojtje sociale (shteti ka detyrim t'i sigurojë kontributet, paratë, ushqimet dhe gjësendet e tjera të nevojshme për qytetarët shoqërisht të rrezikuar), e drejta për mbrojtjen shëndetësore (shteti ka detyrim për ndërtimin dhe pajisjen e objekteve shëndetësore, të punësojë mjekë dhe personelin tjetër të domosdoshëm mjekësor), e drejta për jetë kulturore dhe të drejtat tjera sociale, ekonomike dhe kulturore.

Të drejtat e statusit negativ janë ato që nuk kërkojnë nga shteti aktivitet apo veprimtari, në mënyrë që të realizohen. Përkundrazi, për realizimin e tyre të papenguar është e domosdoshme që shteti të jetë pasiv, joaktiv, kështu që ky lloj i lirive dhe i të drejtave paraqitet i njëjtë me ato të statusit pasiv. Në pyetje janë të drejtat personale, me fillim nga e drejta për jetë e tutje, që përcaktojnë kufijtë e veprimit dhe përzierjes së shtetit në sferën personale të individit. Ajo që kërkohet nga shteti kur janë në pyetje liritë dhe të drejtat personale është mbrojtja. Kështu, ta zëmë, nëse është cenuar liria personale nga individi ose pushteti, mbi shtetin bie barra e sanksionimit dhe kthimit të saj te qytetari.

Sipas asaj se kush është bartës i të drejtës (me kënd kanë të bëjnë), liritë dhe të drejtat mund të ndahen në liri dhe të drejta të **njeriut**, **qytetarit** dhe **shtetasit**. Dallimin në mes të drejtave të njeriut dhe të qytetarit bëhet qysh në Deklaratën e vitit 1789, e cila praktikisht konsiston në dallimin në mes të drejtave natyrore dhe të drejtave qytetare. Të drejta të njeriut janë ato që i takojnë çdokujt si qenie njerëzore ("homo sapiens"). Ato janë të drejta natyrore që fitohen me vetë lindjen (bile edhe para lindjes – të drejtat nga trashëgimia) dhe nuk fitohen nga shteti. Pushteti me aktet e veta duhet t'i konformojë dhe t'i mbrojë. Për nga origjina, të drejtat e njeriut i takojnë kategorisë së të drejtave më të vjetra, sepse janë të pandashme si pjesë e qenies njerëzore në çdo shoqëri, që nga kohërat parashtetërore. Ato kanë ekzistuar para se njerëzit të organizojnë shoqëritë e tyre nëpër shtete". Zbulimi" i tyre, megjithatë, lidhet për qëndrimet e filozofëve antikë dhe mendimtarëve të **Greqisë** e **Romës** së vjetër, nga sofistët përmes **Platonit** (Plato: 427 - 347 p.e.s.) dhe **Aristotelit** (Aristotele: 384-322), stoikëve nga **Ciceroni** (Cicero: 106-43 p.e.s.) dhe **Seneka** (Lucius Annaeus Seneca: 4 p.e.s. – 65 e.s.). Ato janë për sa vijon: e drejta për jetë, liri, fat dhe lumturi, drejtësi, arsyeshmëri.

Të drejtat e qytetarit (të drejtat qytetare) lidhen për bartësin e të drejtave politike. Qytetari, për dallim nga kuptimi i njeriut, bartë me vete një ideologji liberale dhe ka të drejta që e bëjnë subjekt aktiv të bashkësisë politike – nga liria e fjalës, shtypit (medies), të drejtave zgjedhore e deri e drejta për arsimim dhe jetë kulturore. Nocioni i qytetarit shumë shpesh idealizohet, qysh nga koha e **Zh. Zh. Rusosë**, i cili, në traktatin e vet filozofik "Emil, ose mbi Edukimin" (1762), përshkruan rastin e gruas spartane, si shembull qytetarie, e cila, pasi kupton për humbjen e pesë fëmijëve të saj, me krenari falënderon hyjnitë për fitoren e **Spartës**.[24] Në të njëjtën kohë, liritë dhe të drejtat politike i sjellin qytetarit përgjegjësi politike. Sipas origjinës së tyre, të drejtat qytetare janë dukuri e vonshme në krahasim me të drejtat natyrore – njihen dhe realizohen vetëm në shtet që ka kushtetutë dhe rend demokratik (demokraci kushtetuese e proveniencës liberale perëndimore).

---

[23] Robert Alexy, *A Theory of Constitutional Rights* (Oxford University Press: Oxford, 2010), fq.163-177.

[24] Jean Jacques Rousseau*, Emile or On Education* (Basic Books: USA, 1979), fq. 40 (krejt libri i parë i dedikohet virtytit të qytetarisë, që nga lashtësia greko-romake); Cf. gjithashtu edhe Annie K. Smart, *Citoyennes: Women and the Ideal of Citizenship in Eighteenth-Century France* (University of Delaware Press: Newark, 2011), fq. 25-60.

Të drejtat e shtetasit i realizon vetëm qytetari që me shtetin qëndron në një marrëdhënie juridiko-publike që quhet shtetësi. Shtetasi është pjesëtar i një shteti dhe posedon, përveç të drejtave njerëzore, edhe liri, të drejta e detyrime që rrjedhin nga shtetësia. Liritë, të drejtat dhe detyrimet që i kanë vetëm shtetasit, zakonisht kanë të bëjnë me sa vijon: të drejtat zgjedhore dhe të drejtat tjera politike, e drejta e pronës në tokë, detyrimi mbrojtjes së vendit, pagimi i tatimeve.

Në themel të lirive dhe të drejtave natyrore qëndrojnë liritë dhe të drejtat që bazohen në vlera morale, etike, siç janë kategoritë: me vend, pa vend, e drejtë, e padrejtë, me ndërgjegje, pa ndërgjegje, e vërtetë dhe e ndershme dhe anasjelltas dhe kështu me radhë. Këto të drejta, kushtimisht i quajmë "të drejta etike" (sepse morali dhe etika nuk janë gjithnjë të njëjtë), në të vërtetë janë produkt i qëndrimeve morale të shumicës në një shoqëri, që nuk janë të detyrueshme juridikisht. Vetëm atëherë kur të shprehen në normë juridike, këto qëndrime bëhen juridikisht të detyrueshme. Kështu, ta zëmë, e drejta për gjyqe të pavarura, gjykim të drejtë dhe mbrojtje, për nga natyra e tyre përmbajnë drejtësinë dhe të vërtetën, si vlera morale, që mund të realizohen vetëm pranë gjykatës së pavarur që gjykon objektivisht në mënyrë të drejtë dhe respekton të drejtën për mbrojtje juridike. Në këtë rast, e drejta dhe e vërteta, përkatësisht dëshira për drejtësi, nuk janë juridikisht të detyrueshme për aq sa nuk janë kategori të së drejtës pozitive. Për dallim nga vlerat juridike, vlerat etike formohen dhe ndryshojnë ngadalë dhe në mënyrë graduale. Mund të thuhet se morali individual dhe kolektiv kurrë nuk arrijnë në tërësi të përputhen me të drejtën pozitive, as e drejta me moralin.

Për dallim nga të drejtat etike, të drejtat ligjore çdo herë janë pjesë e të drejtës pozitive, qoftë kur në themel të tyre qëndron morali, zakoni apo ideologjia. E drejta zakonore në një rast konkret mund të kufizohet për arsye etike, të cilat janë futur në normën juridike. Pushteti i gjyqtarëve për të gjykuar është i kufizuar ashtu që nuk mund të veprojë në lëndët ku palët janë anëtarë të familjes së saj/tij, apo kolegëve të saj/tij, për shkak të konsideratave morale që lidhen me gjykimin e ndershëm dhe të drejtë.

Të drejtat ligjore i hasim në kushtetuta, marrëveshje dhe instrumente të tjera ndërkombëtare, ligje dhe akte të tjera juridike, në varësi të rëndësisë që ua kanë dhënë kushtetutëbërësi dhe ligjvënësi nacional. Në këtë mënyrë, jo të gjitha liritë dhe të drejtat njerëzore gjejnë vend në aktin më të lartë juridik – kushtetutë. Me kushtetutë përcaktohet përmbajtja e tyre, drejtpërdrejt zbatohen në raste konkrete dhe gëzojnë mbrojtjen juridiko-kushtetuese pranë gjykatës kushtetuese apo gjykatave të rregullta, prandaj quhen të **drejta kushtetuese**. Disa liri dhe të drejta kushtetuese, kushtetuta i normon vetëm në nivel parimi, në ndërkohë që me ligj saktësohet përmbajtja e lirisë dhe të drejtës (ta zëmë, e drejta për shtetësi). Ligji garanton liritë dhe të drejtat e njeriut që nuk bien në kategorinë më të lartë në hierarkinë normative të sistemit juridik, përkatësisht në kategorinë e "të drejtave themelore", por në kategorinë juridike në të cilën subjektet, përmbajtja dhe kushtet për realizimin e tyre janë të përcaktuara me ligj. Këto janë të **drejta ligjore** në kuptimin e ngushtë të fjalës, siç është ta zëmë, e drejta për mbajtje të armëve. E themi kushtimisht për arsye se, ligji është i domosdoshëm për realizimin e lirive dhe të drejtave themelore, siç është ta zëmë, e drejta për arsimin pa pagesë nuk mund të realizohet nëse me ligj nuk sigurohen burimet e financimit të arsimit, mënyra e themelimit të institucioneve arsimore, përpilimi i programeve arsimore dhe punësimi i arsimtarëve.

Liritë dhe të drejtat e njeriut mund të klasifikohen në **liri dhe të drejta individuale** dhe **liri e të drejta kolektive**, sipas asaj se kush është bartës i tyre. Premisë fillestare e shtjellimit të kësaj fushe është se liritë dhe të drejtat e njeriut, në rend të parë iu takojnë individëve, të cilët janë subjekte të tyre, si njerëz, si qytetarë dhe si shtetas. Për shumicën e lirive dhe të drejtave të njeriut vlen rregulli i përgjithshëm – secili individ është subjekt i së drejtës. Të drejtat dhe liritë kolektive, megjithatë, nuk kanë këtë veti të përgjithshme, sepse lidhen për kolektivitetin apo grupin: individi është bartës i të drejtave dhe lirive, por si anëtar i kolektivitetit apo grupit që ka cilësi të përcaktuara. Kështu, ta zëmë, të punësuarit kanë një mori të drejtash kolektive, njëra ndër to është e drejta për fitim; nxënësit kanë të drejtën për shkollim pa pagesë; personat shoqërisht të rrezikuar kanë të drejtën për ndihmë sociale; pjesëtarët e pakicave kom-

bëtare, fetare, gjuhësore dhe pakicat tjera dhe kështu me radhë kanë liri dhe të drejta shtesë dhe kështu me radhë.

Sipas vlerës që mbrohet, liritë dhe të drejtat e njeriut mund të ndahen në **liri dhe të drejta personale**, **liri dhe të drejta politike**, **liri dhe të drejta sociale, ekonomike dhe kulturore**, **liri dhe të drejta që u takojnë pakicave të ndryshme** (kombëtare, fetare, gjuhësore, bazuar në orientimin seksual dhe kështu me radhë) dhe, së fundi, **liritë dhe të drejtat e të huajve**. Të parat janë ato që mbrojnë jetën, trupin, dinjitetin, lirinë, mendimin, ndërgjegjen dhe vlera të tjera që janë cilësi e çdo njeriu. Të dytat, ndërkaq, janë liri dhe të drejta që i mundësojnë individit dhe kolektivitetit apo grupit aktivitetin politik, siç janë, ta zëmë, e drejta e organizimit dhe tubimit, të drejtat zgjedhore, liria e shtypit, pjesëmarrja në organet e pushtetit dhe administratën publike. Grupimi i tretë përbën një grupim të madh dhe të ndryshëm nga dy të parat, në të cilin hyjnë, ta zëmë, e drejta për punë, shëndet, sigurim social, pjesëmarrje në jetën kulturore, informim dhe kështu me radhë. Së fundi, një grupim të posaçëm formojnë **liritë dhe të drejtat e pakicave**. Në parim, pakicat gëzojnë liritë dhe të drejtat që gëzojnë të gjithë të tjerët, por krahas tyre ato kanë liri dhe të drejta shtesë që shërbejnë për ruajtjen e identitetit të tyre. Në këtë grup hyjnë të liri dhe të drejta të veçanta politike, liri dhe të drejta të veçanta me qëllim të ruajtjes së gjuhës dhe shkrimit të pakicave, ruajtjes dhe kultivimit të lidhjeve kulturore dhe lidhjeve të tjera me bashkatdhetarët e tyre, liri dhe të drejta krejt të posaçme për ruajtjen dhe kultivimin e identitetit të ndarë që lidhet për orientimin seksual të individit dhe cilësitë tjera të pakicave të vendosura prej tyre me vullnet, dhe kështu me radhë. Një grup i dallueshëm i lirive dhe të drejtave janë ato që kanë të bëjnë me të huajt dhe që figurojnë në shumë kushtetuta bashkëkohore si kategori e posaçme. Sipas rregullit, të **huajt gëzojnë** liritë dhe të drejtat si çdo individ tjetër, përveç atyre që me kushtetutë e ligje nacionale janë të rezervuara për shtetasit. Në fund, shënojmë se në një grup të veçantë mund të futen edhe kategoria e **detyrave të qytetarëve**. Numri i tyre nëpër kushtetuta dhe ligje është më i vogël se sa vëllimi i lirive dhe të drejtave të tjera.

Sipas kohës së pranimit dhe garantimit të tyre, në fillim liritë dhe të drejtat e njeriut janë ndarë në **tri kategori**. [25] Gjeneratën e parë, **të drejtat e kaltra**, e përbëjnë liritë dhe të drejtat civile dhe politike. Këto janë liri dhe të drejta negative, sepse nga shteti kërkohet përmbajtje dhe pëlqim. Kjo gjeneratë konsiston ekskluzivisht në të drejta civile dhe politike. Ka lindur nga teoritë dhe praktikat politike të shekujve XVII dhe XVIII, në kontekstin e revolucioneve angleze, amerikane dhe franceze, pra kanë karakter thellësisht borgjez liberal. Simbol i këtyre lirive dhe të drejtave është shprehja e njohur sipas së cilës "jeta, liria, dhe kërkimi i lumturisë " janë synim i njeriut në një bashkësi të organizuar politike. Për këtë arsye, këtu favorizohet kufizimi i pushtetit shtetëror përmes vënies së kufijve ndaj aktivitetit shtetëror në sferat e caktuara që mbrohen nga këto liri dhe të drejta. Grupin e dytë, **të drejtat e kuqe**, e formojnë liritë dhe të drejtat sociale, ekonomike dhe kulturore. Këto janë më të vonshme se gjenerata e parë. Janë liri dhe të drejta pozitive, sepse për realizimin e tyre nga shteti kërkohet aktivitet apo veprim. Kjo gjen-

[25] Këtë ndarje kësisoj për herë të parë e ka bërë në vitin 1977 juristi çek, **Karel Vashak** (Karel Vašák: 1929-2015), në një shkrim në revistën "UNESCO Currier", në cilësinë e funksionarit të lartë të OKB-së. Në këtë shkrim ai ka bërë kategorizimin e të drejtave të njeriut sipas gjeneratave, në tri sosh. Në gjeneratën e parë ka futur të drejtat civile dhe politike, në veçanti ato që janë të mishëruara në **PDCP**, siç janë liria e shprehjes dhe e drejta për votë. Gjenerata e dytë ka të bëj me të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore të mishëruara në **PDESK**, sic është e drejta për strehë dhe formim të sindikatave. Gjenerata e tretë, me të cilën **Karel Vashak** thotë "bashkësia ndërkombëtare sapo ka nis të merret", ka të bëj me të drejta që ai i ka cilësuar si "të drejtat e solidaritetit", në të cilën ka futur të drejtën për zhvillim, të drejtën për vetëvendosje, të drejtat e pakicave, e drejta për ambient të shëndetshëm, e drejta për paqe dhe e drejta për pronësi ndaj trashëgimisë së përbashkët të njerëzimit. Cf. Karel Vasak, "A 30 Year Struggle". *UNESCO Courier* (November 1977), fq. 29 & 32, në fq. 29.; Cf. më shumë në Spasimir Domaradzki & Margaryta Khvostova & David Pupovac, "Karel Vasak's Generations of Rights and the Contemporary Human Rights Discourse". *Human Rights Review* (2019) Vol. 20 No. 4 (2019) fq. 423-443; Për komente kritike ndaj ndarjes në gjenerata, përtej këtij klasifikimi në tri grupe, cf. më shumë edhe në Patrick Macklem, "Human rights in international law: three generations or one?" *London Review of International Law*, Volume 3, Issue 1 (March 2015), fq. 61- 92.

eratë zgjeron fokusin, duke u shtrirë ndaj lirive dhe të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore. Sipas kësaj qasje, të drejtat kanë më shumë karakter pozitiv se sa negativ, kështu që inkurajohet intervenimi apo ndërhyrja e shtetit për realizimin e tyre. Promovues dhe përqafues të flaktë të tyre kanë qenë vendet ish-komuniste. Si shembuj të këtyre të drejtave janë nenet 22-27 të **DUDNJ-së**, ku përfshihet e drejta e sigurimit social, e drejta për punë, e drejta për standard jetësor adekuat me shëndetin dhe mirëqenien e vetvetes dhe të familjes, e drejta për edukim dhe kështu me radhë.

Për dallim nga dy gjeneratat si më sipër që fokusohen në liri dhe të drejta individuale, gjeneratat tjera më shumë kanë të bëjnë me kolektivitete apo grupime abstrakte njerëzore si përfitues të tyre. Kështu, ta zëmë, në gjeneratën e tretë, **të drejtat e gjelbra**, hyjnë liritë dhe **të drejtat e solidaritetit**, dhe ka lindur si pasojë e ngritjes dhe rënies së kombit-shtet në gjysmën e dytë të shek. XX. Liritë dhe të drejtat nga ky grup janë promovuar dhe përkrahur nga **Bota e Tretë** (vendet në zhvillim), prandaj që atëherë kanë ngelur si liri dhe të drejta shumë të debatueshme. Këtu hyjnë disa liri dhe të drejta specifike, siç janë: e drejta për vetëvendosje politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, e drejta për zhvillim ekonomik dhe shoqëror, e drejta për pjesëmarrje në "të mirën e përbashkët të njerëzimit" etj. Flitet edhe për **gjeneratën e katërt** të lirive dhe të drejtave të njeriut, e cila përfshinë të drejtat e kafshëve, të cilat, deri vonë kanë qenë objekt i të drejtës, jo subjekt i saj (përfitues nga e drejta), si dhe për **gjeneratën e pestë**, e cila përfshinë të drejtën për mjedis të qëndrueshëm jetësor, ky hyjnë e drejta për ushqim, ujë, tokë dhe ajër.

4. Kushtet dhe parimet e realizimit të lirive dhe të drejtave të njeriut

Që liritë dhe të drejtat të mund të realizohen dhe detyrat qytetare të kryhen, duhet të plotësohen kushte e parime të caktuara, siç janë: ekzistimi i subjektivitetit juridik, barazia, ndalimi i keqpërdorimit të lirive dhe të drejtave dhe përcaktimi paraprak i kushteve për kufizim të lirive dhe të drejtave.

Vetëm qeniet njerëzore mund të realizojnë liritë dhe të drejtat njerëzore dhe të kryejnë detyrat qytetare. Kjo nënkupton se atyre u njihet subjektiviteti juridik, përkatësisht e drejta në personalitet. Nga aktet juridike-ndërkombëtare, ky kusht i realizimit të lirive dhe të drejtave është bartur në kushtetuta e ligje nacionale. Me nenin 6 të **DUDNJ-së** qartë përcaktohet se çdo kush në çdo vend duhet të pranohet si person. Thuajse **ad literam** kjo është bartur në nenin 16 të PDCP-së, mirëpo duke ia shtuar fjalinë "para ligjit", përkatësisht se "çdo kush në çdo vend ka të drejtë të pranohet si person para ligjit".

Të qenit subjekt i së drejtës nënkupton pasjen e **zotësisë juridike** dhe **zotësisë së veprimit**. Zotësinë juridike e posedon çdo kush, sepse ajo lind me njeriun (me përjashtime të rralla në çështjet e trashëgimisë): zotësia juridike nënkupton të qenit bartës i të drejtave dhe detyrimeve. Ajo, si e tillë, nuk i nënshtrohet kufizimeve. Për dallim nga zotësia juridike, zotësinë e veprimit nuk e posedon çdo njeri. Ajo fitohet me automatizëm me disa kushte, siç janë të qenit madhor dhe të gëzuarit e shëndetit të duhur psikik (shpirtëror), por mund të kufizohet, si dhe të merret, me vendim të veçantë të organit kompetent – gjykatës. Zotësia e veprimit do të thotë që personi mund të hyj në marrëdhënie juridike në mënyrë të pavarur, të disponoj me të drejta dhe jetë bartës i detyrimeve. Zotësinë e veprimit e kanë edhe **personat juridikë**, që do të thotë se edhe ata mund të jenë bartës të të drejtave dhe detyrimeve të caktuara, siç janë, ta zëmë: e drejta për emër të mirë, detyrimi i mbrojtjes së ambientit jetësor dhe pagimit të tatimit, e drejta e shprehjes së mendimit dhe qëndrimeve etj. Personat juridikë, gjithashtu mund të zhvishen nga zotësia e veprimit, e njëjta mund t'iu kufizohet në një procedurë të përcaktuar (falimentimi dhe likuidimi i personave juridikë).

Barazia është kusht dhe parim i realizimit të lirive dhe të drejtave të njeriut. Ka qenë kërkesë dhe moto e revolucionarëve francezë në vitin 1789, që nxorën si një kundërpeshë ndaj shtetit aristokratik feudal të kohës që bazohej në pabarazinë juridike dhe politike. Edhe revolucionarët amerikanë më herët kishin miratuar **Deklaratën e Pavarësisë**, sipas së cilës të gjithë njerëzit janë të barabartë. Në literaturë është vërejtur se ideja e barazisë është me origjinë hyjnore, sepse të gjithë shpirtrat njerëzor janë të barabartë

para Hyjit.[26] Barazia nuk nënkupton se të gjithë njerëzit janë të njëjtë në aspektin fizik dhe shpirtëror (mendor/intelektual). Përkundrazi, secila qenie njerëzore është e veçantë. Në kontekstin që flasim, me barazi nënkuptohet **barazia formale** – barazia e të gjithëve para ligjit. Sipas këtij parimi, parimit të barazisë, të gjithë individët e ndryshëm veç e veç gëzojnë të drejta të njëjta. Kjo, pra, nënkupton barazinë juridike, që mbrohet më të drejtën pozitive, siç është, ta zëmë, e drejta e secilit njeri për të drejtën e votës dhe pjesëmarrje në jetën publike. Realizimi i plotë i barazisë juridike, megjithatë, në praktikë është tërësisht i pamundur: qytetarët juridikisht të barabartë, realisht nuk janë të barabartë (ta zëmë, realizimi i të drejtës për mbrojtje profesionale para gjyqit nuk është e njëjtë për të gjithë njerëzit, për shkak të mundësive, realizimi i të drejtës pronësore gjithashtu etj.). Për të arritur barazinë reale të qytetarëve, shteti nxjerr akte juridike dhe ndërmerr masa shtesë, zakonisht të njohura si **diskriminimi pozitiv** dhe **veprimi afirmativ**, përkundër asaj që këto, në kuptimin e ngushtë të fjalës, bien ndesh me parimin e barazisë formale të qytetarëve. Të drejtat shtesë për pakicat kombëtare dhe pakicat tjera, ndihma materiale nga mjetet publike për shtresat e varfra dhe e drejta e tyre për ndihmë juridike falas, kontribuojnë në realizimin e barazisë reale të qytetarëve.

Barazia mund të definohet edhe negativisht - nuk ekziston nëse ka **diskriminim**. Për këtë arsye ndalimi i diskriminimit paraqet plotësim përmbajtësor të parimit mbi barazinë e qytetarëve. **Diskriminimi** si praktikë paraqet pabarazinë në mes të qytetarëve, vënia e tyre në pozitë të pabarabartë, duke mohuar apo kufizuar të drejtat dhe liritë e njeriut të disave në raport me të tjerët. Ndalimi i diskriminimit nënkupton që të gjithë njerëzit janë të barabartë në të drejta, liri dhe detyrime, pa marrë parasysh racën, ngjyrën, gjininë, fenë dhe besimin, mendimin politik dhe tjetër, prejardhjen nacionale dhe prejardhjen tjetër sociale, pasurinë, lindjen dhe rrethanat tjera. Kështu përcaktohet në nenin 2 të **DUDNJ-së**, që më pastaj është bartur me formulime të ngjashme në të gjitha aktet juridike – ndërkombëtare dhe ato me karakter regjional që normojnë liritë dhe të drejtat e njeriut.

Si pjesë e barazisë juridike është **barazia politike e qytetarëve**, e cila, megjithatë, nuk është e njohur në vëllim të njëjtë sikur barazia juridike dhe shërben si një veçori e **konstitucionalizmit liberal**. Është në evoluim e sipër, zhvillohet vazhdimisht, ta zëmë, përmes reformimit të mënyrave të ndryshme të votimit apo kushteve të kandidimit në zgjedhje dhe ndërmarrjes së hapave të tjerë që reduktojnë pabarazinë politike. Krejt çka nënkupton **barazia politike** konsiston në arritjen e barazisë reale të qytetarëve në realizimin e lirive dhe të drejtave politike. Kjo, në thelb, është përmbajtja e **konstitucionlizmit liberal – demokratik**.

Barazia përqafohet si pika nisëse e të gjitha lirive dhe të drejtave njerëzore dhe si parim themelor i akteve kryesore ndërkombëtare. **DUDNJ-ja** nis me dispozitën për barazinë: "[...] Të gjitha qeniet njerëzore lindin.... të barabartë në dinjitet dhe të drejta [...] "(neni 1). Përveç përshkrimit të ndalimit të diskriminimit, ky dokument në veçanti thekson barazinë para ligjit, të drejtën në mbrojtje të barabartë ligjore, mbrojtjen e njëjtë kundër çdo diskriminimi dhe nxitjes për diskriminim (neni 10). Në **PDCP** disa nga këto postulate përsëriten dhe saktësohen më shumë. Kështu, ta zëmë, **PDCP-**ja thotë se shtetet detyrohen që t'u sigurojnë të drejta të njëjta burrave dhe grave me rastin e shfrytëzimit nga ana e tyre të lirive dhe të drejtave politike; përsëritë parimin e barazisë para gjyqeve, mbrojtjen e njëjtë para ligjit dhe ndalon diskriminimin ndaj të gjithë personave, në veçanti fëmijëve (nenet 3, 24 dhe 26). **PDESK**-ja garanton barazinë e burrave dhe grave, duke detyruar shtete që të sigurojnë shfrytëzimin të gjitha të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore (neni 3). Në **KEDNJ**, barazia nuk përmendet në mënyrë shprehimore, por për ekzistimin e saj mund të konkludohet nga sanksionimi i parimit të ndalimit të diskriminimit (neni 14), dhe nga të gjitha dispozitat tjera ku si subjekt i së drejtës paraqitet "çdokush".

[26] Origjinën religjioze të lirive dhe të drejtave të njeriut e konfirmon vetë **Jellinek**, kur pohon se **Deklarata Pavarësisë së SHBA** nuk ishte vepër e **Lafajetit** por e **Reformacionit Protestant**: ideja e lirive dhe të drejtave individuale si të patjetërsueshme, të qenësishme dhe të shenjta nuk është me origjinë politike por fetare, e cila më pastaj është shndërruar në kushtetutë në ish-kolonitë britanike të **Botës së Re**. Cf. Stephan Kirste, "*The Formal and Substantive Core of Human Rights",* fq. 32 (fusnota 32 **infra,** dhe teksti që e shoqëron).

Dispozitat mbi barazinë e njerëzve gjejnë vendin e tyre në kushtetuta nacionale dhe atë duke përdorur si pikë nisëse për rregullimin dhe realizimin e të drejtave, lirive dhe detyrave të tjera. Kjo barazi përpunohet përmes rregullave mbi barazinë para ligjit, gjyqeve, barazinë e votës dhe ndalimi i diskriminimit. Kjo nuk nënkupton se të gjithë njerëzit kanë pozitë të njëjtë shoqërore (barazimi i plotë), por që juridikisht kanë mundësi të njëjta për zhvillim dhe mbrojtje të personalitetit, që shteti dhe e drejta pozitive kanë qëndrim të njëjtë ndaj secilit anëtar të shoqërisë. Kushtetutat ndalojnë diskriminimin, përkatësisht dallimin në të drejta, liri dhe detyrime bazuar në racë, ngjyrë, nacionalitet, besim fetar dhe tjetër, gjini, prejardhje, profesion dhe cilësi të tjera personale. Kjo nënkupton se konstitucionalizmi bashkëkohor ka ndarë rrugët me praktikat e mëparshme të sistemeve kushtetuese që janë bazuar në dallimin e qytetarëve në bazë të cilësive të tyre personale. Deri vonë në të vërtetë as që ka ekzistuar nocioni i diskriminimit. Si **shembuj historik të diskriminimit** mund të përmenden: përqafimi i superioritetit të racës së bardhë kundrejt të tjerave – racës së verdhë dhe, mbi të gjitha, asaj të zezë (rastet me skllavërinë veri-amerikane, aparteidin afrikano-jugor, racizmin australian), diskriminimi i pakicave fetare dhe kthimi i tyre në një fe apo besim tjetër në mënyrë të dhunshme (praktikat e njohur si **proselitizëm**), akordimi i më shumë të drejtave shtresave të caktuara shoqërore (dy ose më shumë vota për shtresat e pasura, pronarët e tokave dhe të arsimuarit – **Britania e Madhe**, **Belgjika**), që paraqet diskriminim sipas origjinës (prejardhjes), pozitës shoqërore, pasurisë dhe arsimimit. Njëra ndër diskriminimet më të gjata, historikisht shikuar, ka të bëjë me diskriminimin ndaj gruas, përkatësisht diskriminimi në baza të gjinisë. Gratë një kohë të gjatë, përgjatë shekujve e deri vonë, kanë qenë të privuara nga të drejtat politike, në shumë shtete deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, kurse format e diskriminimit faktik të tyre ekzistojnë edhe sot. Kështu, ta zëmë, shpesh përmenden dallimet në të ardhura (fitim), si pjesë e të drejtës në punë, si dhe përjashtimi nga trashëgimi si diskriminime faktike.

Përpjekjet për realizim të barazisë kanë rezultuar në vetëdijesimin se një gjë e tillë nuk është krejtësisht e mundur, pa u braktisur barazia formale e qytetarëve, e përshkruar si më sipër. Kjo ka bërë që anëtarëve të grupeve të caktuara shoqërore u janë njohur **të drejta shtesë**. Kjo nuk konsiderohet si diskriminim ndaj atyre që nuk posedojnë këso të drejta, sepse të drejtat shtesë janë ndihmesë dhe, në fakt, kusht për realizimin e lirive dhe të drejtave të grupeve të caktuara shoqërore. Në këtë kuptim, ta zëmë, **pakicave kombëtare** u garantohen të drejta politike shtesë, siç janë vendet e garantuara në parlament, me qëllim që të sigurohet pjesëmarrja e tyre në pushtet dhe jetën publike në përgjithësi. Njëjtë me këtë, në mënyrë që pakicat të realizojnë të drejtën kushtetuese për identitet nacional dhe fetar dhe të mbrohen nga asimilimi, shteti duhet të ndërmerr masa të posaçme që lehtësojnë përdorimin e gjuhës dhe shkrimit të pakicave apo pjesëmarrjen e tyre në ritet dhe zakonet fetare. Këtë do ta shohim nga afër në vijim, ku diskutojmë zgjidhjet kushtetuese në Kosovë dhe vendet përreth, të cilat përmbajnë dispozita mbi pakicat dhe të drejtat e tyre shtesë.

Një mori masash ndërmerren me qëllim të realizimit të lirive dhe të drejtave politike të **grave**, në veçanti për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre aktive në jetën politike. Si mënyrë e realizimit të barazisë, mjaft shpesh përdoret politika e **mundësive të barabarta**, përmes së cilës qytetarët me pikë nisëse të dobët synohet të vihen në pozitë sa më të barabartë, përmes, ta zëmë, financimit dhe akordimit të bursave për shtresat shoqërisht të rrezikuara apo qasjen në arsim dhe shërbime të personave me invaliditet.

Liritë dhe të drejtat e njeriut realizohen përmes respektimit të kategorisë kushtetuese të **ndalimit të keqpërdorimit** dhe nëse ekziston **mundësia e kufizimit** të tyre, e përcaktuar me kushtetutë. Ndalimi keqpërdorimit nënkupton që liritë dhe të drejtat nuk mund të shfrytëzohen dhe as të përdoren kundër qëllimit për të cilin janë caktuar (vënë) me kushtetutë e ligje. Ekziston keqpërdorimi i të drejtave dhe lirive njerëzore kur bartësi i tyre udhëhiqet nga qëllimi i shkaktimit të dëmit tjerëve, kur zbatimi i tyre për palën tjetër është i rëndë në mënyrë të panevojshme, kur realizimi i lirive dhe të drejtave është i kundërt me moralin apo bie ndesh me drejtshmërinë, kur e drejta zbatohet në kundërshtim me sjelljen

e bartësit tjetër të së drejtës, kur e drejta ushtrohet pa asnjë interes të arsyeshëm apo të rëndësishëm. Të tilla janë, ta zëmë, situatat për sa vijon: kur me fjalim, që është pjesë përbërëse e lirisë së shprehjes së mendimit, nuk shpërfaqet qëndrimi apo mendimi vetjak mbi diçka, por cenohet dinjiteti i personit tjetër; kur liria e lëvizjes përdoret për të lënduar të drejtën e tjetrit për paprekshmërinë e banesës, dhe kështu me radhë. Me keqpërdorimin e të drejtës, ana tjetër privohet nga mundësia për të përdorur (shfrytëzuar) të drejtën e vet, ose një mundësi e tillë i ngushtohet në mënyrë të dukshme.

Ndalimi i keqpërdorimit të lirive dhe të drejtave njerëzore rregullohet me **DUDNJ**, sipas së cilës shteti, grupi ose individi nuk kanë të drejtë të ndërmarrin asnjë aktivitet apo veprim drejtuar kah shkelja e cilësdo të drejtë apo liri të garantuar me te (neni 30). Me keqpërdorim të lirive dhe të drejtave, **DUDNJ-ja** nënkupton edhe situatat kur ato ushtrohen dhe zbatohen në kundërshtim me qëllimet dhe parimet për të cilat janë përcaktuar (neni 29). Dy paktet ndërkombëtare, **PDCP**-ja dhe **PDESK**-ja, përmbajnë dispozita shumë të ngjashme mbi keqpërdorimin e të drejtave. Në të vërtetë, dispozitat e tyre mund të interpretohen vetëm si ndalesa për shtetet, grupet dhe individët për të ndërmarrë aktivitete apo veprime me qëllim të shkatërrimit të lirive dhe të drejtave të garantuara me to (neni 5 i dy pakteve). Ndalimin e keqpërdorimit të lirive dhe të drejtave njerëzore e njeh shprehimisht edhe **KEDNJ**-në. Kjo ka të bëjë me subjektet e njëjtë: shtetin, grupin dhe individin, të cilën nuk mund të shkatërrojnë, apo të kufizojnë më shumë se përcaktohet, liritë dhe të drejtat e përcaktuara me **KEDNJ** (neni 17).

Përkundër krejt ndalesave juridike, keqpërdorimi i lirive dhe të drejtave ekziston çdo herë në një masë të caktuar. Ato i bëjnë grupet dhe individët, por edhe shtetet që kanë ratifikuar apo internalizuar në rendet e tyre të brendshme juridike standardet më të mira ndërkombëtare mbi liritë dhe të drejtat e njeriut dhe që, për pasojë, duhet të jenë vetë mbrojtës të tyre. Krahas keqpërdorimit të tyre, siç u përshkrua më sipër, liritë dhe të drejtat e njeriut mund të shërbejnë edhe si një instrument i fuqishëm për presion politik në marrëdhëniet ndërkombëtare, ndaj shteteve e kulturave që cenojnë ato në mënyrë brutale. Këtë e vërejmë në veçanti te vendet perëndimore, në kulturat politike dhe kushtetuese të vendeve euro-atlantike, ku sundimi i ligjit, demokracia dhe respektimi i lirive dhe të drejtave njerëzore përbën një lajtmotiv që rrezaton fuqishëm në politikat e tyre me jashtë. Kjo ka ardhur në shprehje në mënyrë të dukshme në rastin e shpërbërjes së përgjakshme të **ish-Jugosllavisë**, ku **BE-ja** dhe **SHBA-ja** me aleatët e tjerë të tyre kanë vënë në plan të parë standardin e respektimit të lirive dhe të drejtave njerëzore, në veçanti të lirive dhe të drejtave civile dhe politike, por edhe **të drejtës për vetëvendosje** dhe **autonomi politike**. Në fakt, respektimi i të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit ka qenë standard për njohje të shteteve të reja të dala nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë.[27]

Kufizimi i lirive dhe të drejtave mund të ndodh, por vetëm në masën e përcaktuar dhe të lejueshme. Kjo nënkupton se ato mund të kufizohen përjashtimisht, për arsyet e përcaktuara paraprakisht dhe vetëm në masën që është e domosdoshme. Realizimi i lirive dhe të drejtave kufizohet, ta zëmë, kur nuk merret (hiqet) liria e lëvizjes, por vetëm kufizohet në një pjesë apo hapësirë të caktuar të territorit shtetëror; kur në rast të rrezikut për luftë ose gjatë luftës, detyruesve ushtarakë nuk u lejohet largimi nga shteti; kur ndalohet hyrja në zona ku mbretëron sëmundja ngjitëse; kur lejohet tubimi paqësor, por vetëm në kohë dhe vende të caktuara me qëllim të ruajtjes së rendit dhe paqes etj. Kufizimi i një të drejte ose lirie individuale mund të jetë edhe i tërësishëm, i plotë. Kjo quhet **suspendim.** Në këto situata, individi nuk mund të shfrytëzoj fare lirinë ose të drejtën për një periudhë të caktuar. Vjen deri te **suspendimi** i lirisë dhe të drejtës vetëm nëse qëllimi i suspendimit nuk mund të arrihet me ndërmarrjen e masës më të butë - kufizimit. Të tilla janë rastet, ta zëmë, kur liria e lëvizjes merret përmes shqiptimit të masës së paraburgimit, që shfaqet si e domosdoshme për zhvillimin të procedurës penale,

[27] Cf. më shumë në Enver Hasani, *Self-Determination, Territorial Integrity and International Stability: The Case of Yugoslavia* (National Defense Academy Institute for Peace Support and Conflict Management/PfP-Consortium of Defense Academies and Security Studies Institutes: Vienna, 2003), fq. 285-288.

sepse vetë qëllimi (zhvillimi i procedurës penale) nuk mund të arrihet me masën më të butë, siç është burgu shtëpiak.

Mbi **kufizimin** dhe **suspendimin** e lirive dhe të drejtave të njeriut mund të vendos vetëm organi kompetent në procedurën e përcaktuar me ligj. Sipas rregullit, dy këto masa janë të kufizuara në kohë. Organi që vendos për këto masa është **gjykata.** Në **rrethana të posaçme**, siç janë lufta dhe gjendja e jashtëzakonshme, mbi **kufizimin** dhe **suspendimin** e lirive dhe të drejtave të njeriut mund të vendos organi i veçantë që përkujdeset për mbrojtjen ose sigurinë e vendit (për shembull komanda ushtarake ua ndalon detyruesve ushtarakë që të braktisin vendin). Kufizimi dhe marrja e të drejtës dhe lirisë zgjasin për aq sa vazhdojnë rrethanat që kanë shkaktuar kufizimin (ta zëmë, rreziku i sigurisë së shtetit apo epidemia e sëmundjes ngjitëse) apo deri sa ekziston cilësia e dhënë e personit për shkak të së cilës është marrë apo kufizuar e drejta dhe liria (i pandehuri në procedurën penale, cilësia e të qenit gjyqtar që përjashton aktivitetin politik etj.).

Arsyet për **kufizim** dhe **suspendim** të lirive dhe të drejtave zakonisht lidhen me sigurinë dhe mbrojtjen e vendit, mbrojtjen e rendit dhe paqes, zhvillimin e procedurës penale, mbrojtjen e jetës dhe shëndetit, të drejtave dhe dinjitetit të individit, mbrojtjen e moralit dhe në përgjithësi me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Për arsye të sigurisë së qytetarëve, këto arsye duhen përcaktuar paraprakisht me kushtetutë. Arsyet për **kufizim** dhe **suspendim** të lirive dhe të drejtave, megjithatë, gjenden edhe në ligje e akte nënligjore. **DUDNJ-ja** mbron liritë dhe të drejtat duke përcaktuar se deri te kufizimi i tyre mund të vije vetëm nëse bëhet përcaktimi me ligj për një gjë të tillë (**ligjshmëria e kufizimit** apo **suspendimit**). Përveç kërkesës për ligjshmëri, kufizimet duhet të kenë për qëllim sigurimin e lirive dhe të drejtave të tjerëve dhe plotësimin e nevojave të drejta të moralit, rendit publik dhe mirëqenies së përgjithshme në një shoqëri demokratike (neni 29). Krahas këtyre, për shtetin ekziston detyrimi që, nëse ka pranuar ndonjë marrëveshje ndërkombëtare që rregullon një liri dhe të drejtë njerëzore, atëherë kufizimin e tyre mund ta bëjë vetëm sipas kushteve dhe specifikave të përcaktuara aty (kufizimet e mishëruara).

Arsyet për të cilat bëhet kufizimi apo suspendimi i lirive dhe të drejtave njerëzore duhet të konceptohet asisoj që të jenë në gjendje të mbrojnë interesin e përgjithshëm në raport me interesin individual apo grupor, përkatësisht të mbrojnë të mirën më të rëndësishme në raport me lirinë dhe të drejtën që kufizohet (**legjitimiteti i kufizimit** apo **suspendimit**). Mbrojtja e shtetit është shembull i mbrojtjes së interesit të përgjithshëm, kurse shembull i të mirës më të rëndësishme janë jeta dhe shëndeti në raport me lirinë e lëvizjes. Interesi i individit i mbërthyer në të drejtën dhe lirinë e tij, praktikisht në këtë mënyrë i nënshtrohet interesit të gjerë apo të përgjithshëm, apo interesit të veçantë kur bëhet fjalë për mbrojtjen e një të drejte më të rëndësishme. Krahas kësaj, në çdo rast konkret të kufizimit apo suspendimit të lirive dhe të drejtave njerëzore duhet të ekzistojë nevoja e arsyeshme për një gjë të tillë (arsyeshmëria e kufizimit apo suspendimit).

Nga kufizimi dhe suspendimi i lirive dhe të drejtave duhet dalluar plotësimin e kushteve për realizimin e tyre. Ta zëmë, të gjithëve u garantohet e drejta për punë, mirëpo në një rast konkret kjo e drejtë realizohet nga personat që plotësojnë kushtet që lidhen me kualifikimet arsimore dhe profesionale. Këtu nuk bëhet fjalë për kufizim të së drejtës për punë, sepse ajo nuk nënkupton që çdo kush mund të punoj gjithçka, por për saktësim të kushteve që duhet të plotësohen për realizimin e të drejtës për punë. Njëjtë është situata me të drejtën në arsim, në mbrojtje shëndetësore apo në ndihmë sociale.

Disa liri dhe të drejta nuk është e domosdoshme të kufizohen drejtpërdrejt, sepse kufizimi i tyre rrjedh si pasojë e masave të ndërmarra ndaj një të drejte apo lirie tjetër. Kështu, ta zëmë, me privimin nga liria përmes shqiptimit të masës së paraburgimit, realisht vjen deri të kufizimi i të drejtave të tjera: fshehtësia e letrave, e drejta për punë, e drejta për grevë, të drejtat prindërore dhe kështu me radhë.

Në kohën e **gjendjes së jashtëzakonshme** vije deri te ndryshimi i regjimit të lirive dhe të drejtave të njeriut. Më këtë gjendje nënkuptohen rrethanat dhe fatkeqësitë që kanë goditur shtetin si pasojë e luftës, rrezikut për luftë, kryengritjet e brendshme, katastrofat e shkaktuara si pasojë e natyrës. Në gjendjen e nevojës së domosdoshme, shteti duhet të shmanget nga funksionimi normal i sistemit juridik. Natyra e **gjendjes së jashtëzakonshme** është e atillë që në të konfrontohen dy tendenca kundërthënëse: e para është ruajtja e mbijetesës së shtetit dhe jetës së qytetarëve të tij si vlera supreme, kurse e dyta ka të bëjë me kërkesën për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit. Regjimi i posaçëm i përcaktuar me kushtetutat nacionale, flet qartë për primatin që ka ruajtja e mbijetesës së shtetit, qoftë edhe përmes sakrifikimit të lirive dhe të drejtave të qytetarëve. Mbrojtja e popullit është ligj suprem, kanë thënë romakët (**salus populi, suprema lex)**. Gjendja e jashtëzakonshme e stërzgjatur praktikisht përfaqëson suspendim të kushtetutës dhe sundimit të së drejtës dhe, për pasojë, suspendim të disa prej lirive dhe të drejtave kushtetuese. Të tilla janë rastet e gjendjeve të jashtëzakonshme që ekzistojnë në **Algjeri, Egjipt, Siri**, përkundër faktit që kanë pushuar rrethanat e rrezikshmërisë.

KEDNJ-ja njeh mundësinë e **shmangies** nga standardi i lirive dhe të drejtave njerëzore në rrethanat e ekzistimit të gjendjes së jashtëzakonshme (lufta ose rrezik tjetër publik që kërcënon ekzistencën e kombit). Kjo, megjithatë, mund të bëhet vetëm në masën që është e domosdoshme në situatën e tillë dhe me masa që nuk janë në shpërputhje me detyrimet ndërkombëtare të shteteve. Ky dokument njeh kategorinë e të drejtave të mbrojtura në mënyrë absolute, nga të cilat nuk mund të ketë shmangie as në kohën e gjendjes së jashtëzakonshme, siç janë: jeta, ndalimi i torturës, ndalimi skllavërisë dhe parimi i ligjshmërisë së veprës dhe sanksionit (neni 15). Lista e këtyre të drejtave me karakter absolut është më e gjatë në **Konventën Amerikane mbi të Drejtat e Njeriut** (KADNJ) të vitit 1969, në të cilën përfshihen, krahas të drejtës për jetë, liritë dhe të drejtat si vijon: e drejta në personalitet juridik, e drejta për dinjitet (trajtim njerëzor), liria e ndërgjegjes dhe e besimit fetar, të drejtat e familjes dhe fëmijës, e drejta për shtetësi dhe emër, e drejta për pjesëmarrje në pushtetin publik dhe garancioni i mbrojtjes gjyqësore i këtyre të drejtave dhe lirive (neni 27).

Edhe kushtetutat përcaktojnë se disa liri dhe të drejtat shteti nuk mund t'i kufizojë as në kohën e gjendjeve të jashtëzakonshme, kur rrezikohet ekzistenca e tij. Me këto liri dhe të drejta mbrohen të mirat e pacenueshme që janë e arritur civilizuese e njerëzimit, ashtu që për cenim të tyre nuk mund të ekzistojnë arsye të forta që janë shoqërisht të pranueshme. Në mesin e lirive dhe të drejtave me karakter absolut konsiderohen ato që mbrojnë vlerat për sa vijon: jetën, dinjitetin, integritetin fizik dhe psikik, lirinë (ndalimi i robërisë, tregtisë me njerëz, punës së dhunshme), ndalimi i nxitjes së urrejtjes racore, nacionale dhe fetare, ndalimi i diskriminimit, të drejtat që kanë të bëjnë me pozitën në procedurë gjyqësore (e drejta për mbrojtje, ndalimi i marrjes së provës me shtrëngim dhe dhunë, e drejta për gjykim të drejtë e të paanshëm), siguria juridike, e drejta për shtetësi, e drejta për subjektivitet juridik, kombësi dhe besim fetar.

Shikuar nga këndi i mbrojtjes juridike, këto liri dhe të drejta mbrojtjen e tyre absolute e kanë në raport me shtetin. Kjo do të thotë se pushteti nuk mund të nxjerr akte juridike me të cilat të kufizojë apo suspendojë liritë dhe të drejtat e karakterit absolut. Nëse shikohet realiteti, megjithatë, mbrojtja e këtyre lirive dhe të drejtave nuk mund të jetë kurrë e plotë sepse ato faktikisht ka mundësi të kufizohen dhe suspendohen, si me veprimet e kundërligjshme të individëve, ashtu edhe përmes keqpërdorimeve nga pushteti shtetëror.

Në mesin e të drejtave të mbrojtura në mënyrë absolute veçohet e drejta për jetë (në kuptimin e ngushtë të fjalës), e cila për shkak të vetë natyrës as nuk mund të kufizohet, pjesërisht të suspendohet (nuk mund të merret jeta e njeriut pjesërisht). Mbrojtja absolute e të drejtës për jetë konsiston në rend të parë në ndalimin e shqiptimit të dënimit me vdekje. Përkundër kësaj, dhe faktit që e drejta për jetë është burim i krejt lirive dhe të drejtave të tjera njerëzore, dënimi me vdekje përbën ndalesë absolute vetëm në gjysmën e shteteve të bashkësisë së sotme ndërkombëtare.

5. Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut

Çështja e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut është e lidhur me cenimin apo shkeljen e tyre, përkatësisht me nevojën e ndërhyrjes së shtetit për të mundësuar realizimin e tyre. Në këtë kuptim, mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut paraqet masën e fundit që ndërmerret me qëllim të realizimit të lirisë dhe të drejtës konkrete. Në vetvete, mbrojtja nuk mjafton për realizimin pa pengesë të lirive dhe të drejtave të njeriut, sepse një gjë e tillë varet nga shumë faktorë në shtet, siç janë: pasuria materiale e shoqërisë, niveli i bashkëpunimit dhe konfliktit social, toleranca, vlerat demokratike dhe tradita, arsimimi dhe ndërgjegjja morale e qytetarëve, zhvillimi dhe ndikimi i opinionit publik.

Mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut e përbën **sistemi treshtresor i dispozitave** që normojnë procedurën, instrumentet juridike të mbrojtjes dhe organet shtetërore që mbrojnë liritë dhe të drejtat e njeriut. Duhet vënë në dukje, megjithatë, se janë organet e administratës, bile edhe vetë gjyqësori, ato nga të cilat ka nevojë të mbrohen liritë dhe të drejtat njerëzore.

Mbrojtja e lirive dhe të drejtave njerëzore rregullohet me **kushtetutë** dhe **ligje**. Me kushtetutë ato **garantohen**, kurse ligji rregullon realizimin e mbrojtjes, duke përcaktuar **instrumentet juridike** të mbrojtjes, **organet** pranë të cilave është e mundur mbrojtja dhe, së fundi, **procedurën** e mbrojtjes. Në mënyrë që të realizohen liritë dhe të drejtat e njeriut, në një shoqëri demokratike, atëherë duhet të ekzistojë një kusht minimal. Ai kusht ka të bëjë me **ekzistimin e një gjyqësori të pavarur**. Vetëm **një gjyqësor i pavarur**, institucionalisht i organizuar, me gjyqtarë në të cilët nuk mund të ndikohet, mund të mbrojë liritë dhe të drejtat e njeriut në raport me organet e pushtetit.

Procedura për realizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut **pranë organeve të administratës** nis me kërkesë (ta zëmë, me kërkesën për lëshimin e pasaportës, si një mënyrë për realizimin e të drejtës për shtetësi). Mbrojtja e lirive dhe të drejtave mundësohet vetëm në procedurën para organit të administratës të shkallës së dytë, të cilit i parashtrohet ankesa/prapësimi ndaj vendimit të shkallës së parë. Vazhdimi i procedurës së mbrojtjes bëhet përmes konfliktit administrativ, që zhvillohet para gjykatës së kompetencës së përgjithshme apo pranë gjykatës së veçantë administrative dhe fillon me paraqitjen e **padisë**. Në konfliktin administrativ verifikohet ligjshmëria e veprimit të organeve të administratës lidhur me kërkesën për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut **pranë gjykatave të rregullta** është forma themelore e mbrojtjes, konform parimit sipas të cilit çdo kush ka të drejtën e qasjes në gjykatë. Para gjykatës nis procedura për vërtetim nëse një liri apo e drejtë njerëzore është kufizuar apo suspenduar, apo nëse gjendja e tillë ka ekzistuar për një kohë dhe më pastaj është ndërprerë. Për këtë parashtrohet **padi**, me të cilën kërkohet që të ndërpritet shkelja e tillë e të drejtës apo lirisë së garantuar, përmes ndërprerjes së veprimit të cenimit dhe përmbajtjes së mëtejme nga cenimi, përkatësisht që gëzimi i lirive dhe të drejtave në vëllim të plotë të rikthehet (**restitutio in integrum**). Krahas kësaj, paditësi mund të kërkon kompensimin e dëmit për kohën sa ka zgjatur kufizimi i të drejtës, për shkak të, ta zëmë, zgjatjes së pabazë të paraburgimit dhe suspendimit të lirisë personale. Mbrojtja gjyqësore e lirive dhe të drejtave është dyshkallëshe, që nënkupton se ndaj vendimit të shkallës së parë mund të parashtrohet ankesë. Në praktikë, megjithatë, ka pasur raste kur gjykatat me vendimet e tyre kundërligjore kanë cenuar liritë dhe të drejtat e njeriut, në vend se të mbrojnë ato. Rast ekzemplar i kësaj është afera e njohur **Drajfus** (**l'affaire Dreyfus**: 1894-1906), padrejtësia më drastike e sistemit francez të drejtësisë së asaj kohe. Në të gjitha procedurat e mësipërme juridike të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, përjashtimisht mund të përdoren mjetet e jashtëzakonshme juridike, kur për një gjë të tillë plotësohen kushtet e kërkuara ligjore.

Një formë e posaçme e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të garantuara me kushtetutë është pranë **gjykatës kushtetuese**. Kjo mbrojtje e drejtpërdrejtë – qytetari drejtpërdrejt i drejtohet gjykatës

kushtetuese – vihet në lëvizje përmes **ankesës kushtetuese**, në rastet kur, sipas rregullit, pala ka shterur të gjitha instrumentet tjera juridike. Në këtë kuptim, ajo është një mjet i veçantë juridik i mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, kur mbrojtja përmes rrugëve të tjera juridike më nuk mund të realizohet. Me miratimin e ankesës kushtetuese, përkatësisht të kërkesës (**petitumit**) të saj, ofrohet mbrojtja dhe, në të njëjtën kohë, konstatohet cenimi i lirisë dhe të drejtës njerëzore dhe, për pasojë, shkelja e kushtetutës. Vendimi sipas **ankesës kushtetuese** është përfundimtar, i ekzekutueshëm dhe prodhon efekt juridik, sipas rregullit, vetëm ndaj palëve në procedurë (**inter partes**).

Objekt i ankesës kushtetuese më së shpeshti janë aktet individuale juridike, me të cilat cenohet një e drejtë ose liri e garantuar me kushtetutë. Ka përjashtime nga kjo rregull, si ta zëmë në Austri dhe Gjermani, ku objekti është më i gjerë dhe përfshinë edhe aktet e përgjithshme. Për këtë arsye, në praktikën krahasimore të gjyqësisë kushtetuese bëhet dallimi në mes të **ankesës së plotë kushtetuese** dhe **ankesës jo të plotë kushtetuese**. Në rastin e parë, me ankesë mund të goditet si baza faktike, ashtu edhe ajo juridike e vendimmarrjes së organeve të tjera të sistemit juridik nacional, kurse në të dytin vetëm ana juridike, jo edhe ana faktike, e procedurës në të cilën është formuar vendimi apo akti juridik që goditet me ankesë kushtetuese. Ankesën kushtetuese e parashtron qytetari liria apo e drejta e të cilit është cenuar, por ekzistojnë zgjidhje kushtetuese ku ankesa mund të parashtrohet edhe nga një grup më i gjerë i personave – personat juridik, avokati i popullit, prokurori publik, apo njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Përveç si më sipër, **gjykata kushtetuese** mund të ketë kompetencë për vendosjen e të drejtës apo lirisë konkrete përkundër ankesës kushtetuese. Të tilla janë situatat, ta zëmë, me mbrojtjen e të drejtës së votës në kontestet zgjedhore ose të drejtës për bashkim politik, në rastet e ndalimit të partisë politike dhe kështu me radhë. Në mënyrë të tërthortë, gjykata kushtetuese mbron liritë e të drejtat njerëzore kur bën vlerësimin e kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese, ligjeve dhe normave të tjera të përgjithshme juridike. Ajo mund të sjell vendim për jokushtetutshmërinë e amendamentit kushtetues, ligjit apo dispozitës tjetër të përgjithshme juridike vetëm sa i përket pjesës që lidhet me kufizimin e lirive dhe të drejtave. Në një rast të tillë, ajo me vendim i largon nga rendi juridik vetëm ato pjesë që janë përlyer me shkelje kushtetuese.

Mbrojtjen e lirive dhe të drejtave kushtetuese e ofron edhe **avokati i popullit**, i cili mban emra të ndryshëm në vendet të ndryshme: quhet mbrojtës i qytetarëve (Kanada), komisari parlamentit (Britania e Madhe), mbrojtës i popullit (Spanjë), ndërmjetësues i Republikës (Francë) etj. Avokati më së shpeshti zgjidhet nga parlamenti dhe përcjell realizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, tërheq vërejtjen në shkeljet e tyre, propozon masa për mënjanimin e shkeljeve dhe përparimin e realizimit të tyre, nis procedurën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave pranë organit kompetent, ka të drejtën e iniciativës ligjore. Avokati mund të organizohet edhe si organ i specializuar, që ka të bëjë me mbrojtjen nga disa lloje të shkeljeve të lirive dhe të drejtave të njeriut, me forma të ndryshme të diskriminimit, apo sfera të caktuara të veprimit, si p.sh.: avokat ushtarak, avokat policor dhe kështu me radhë.

Mbrojtja e lirive dhe të drejtave nga **avokati i popullit** nuk është mbrojtje juridike, por mbrojtje në procedurat për realizimin e lirive dhe të drejtave njerëzore nga padrejtësitë e mëdha dhe të vogla, nga zvarritjet, joefikasiteti dhe pasiviteti i organeve të administratës dhe subjekteve të tjera që ushtrojnë autorizime publike. Për këtë arsye, qytetarët i drejtohen avokatit të popullit edhe në mënyrë joformale, me komunikim të zakonshëm, jo me instrument juridik dhe me plotësim të prezumimeve procedurale. Kur ndiqen procedurat formale, atëherë kërkohet parashtrimi i aktit fillestar (rekursi/parashtresa/kërkesa) dhe që më herët të jenë provuar procedurat tjera relevante juridike për realizimin e të drejtës apo lirisë së shkelur. Pas pranimit të aktit fillestar, avokati nis procedurën e mbrojtjes. Në çdo rast konkret të shkeljes së pretenduar, avokati bën hetimin e fakteve, mbledh prova, merr deklarata, propozon masa, në pajtim me rrethanat nën të cilat ka ndodhur shkelja e lirisë apo të drejtës njerëzore. Vendimet e avokatit të popullit **nuk janë akte juridike të ekzekutueshme** që mund të përmbarohen

në mënyrë të dhunshme, por rekomandime për organin lidhur me mënyrë e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut. Avokati përpilon raporte periodike mbi gjendjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe, në veçanti, thekson rastet e shkeljes së tyre nga ana e organeve të pushtetit dhe autoriteteve të tjera publike – policisë, administratës së burgut, organit ushtarak, institucionit shëndetësor apo shkollës.

Sipas pozitës, avokati i popullit është organ i pavarur dhe i paanshëm që mbron të drejtat e njeriut dhe liritë ndaras nga organet tjera të mbrojtjes (administratës, gjykatave, gjykatës kushtetuese) dhe nuk paraqet zëvendësim për mbrojtje gjyqësore ose mbrojtje tjetër. Ky organ në të vërtetë, më së shumti komunikon me publikun dhe me autoritetin, trimërinë, maturinë, dijeninë dhe drejtëshmërinë ndikon në realizimin e mbrojtjeve të caktuara të lirive dhe të drejtave. Organi që ka cenuar lirinë dhe të drejtën duhet me aktin e veprimit apo me mosveprim (durim) të mundësojë realizimin e lirive dhe të drejtave të cenuara, por në mënyrë vullnetare, jo në bazë të dokumentit të ekzekutueshëm që këtu nuk ekziston.

Nga fakti se liritë dhe të drejtat e njeriut kanë natyrë universale, mbrojtja e tyre nuk bëhet vetëm brenda shteteve. Krahas kësaj ekziston edhe **mbrojtja ndërkombëtare**, e cila bazohet në rekomandimet dhe vendimet e trupave dhe gjykatave ndërkombëtare. Në bazë të pakteve të vitit 1966, PDCP-ja dhe PDESK-ja, janë themeluar respektivisht **Komiteti për të drejtat e njeriut** dhe **Komiteti për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore**. Komitetet nuk kanë autorizime ekzekutive, pos dërgimit të rekomandimeve shteteve lidhur me realizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Përveç kësaj, ato konstatojnë shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut (për këtë pranojnë parashtresa nga burime të ndryshme), gjë që mund të çojë në dënim politik dhe moral të shtetit që ka kryer shkeljen e konstatuar. Përveç këtyre ekzistojnë edhe komitetet të tjera, siç janë komitetet: kundër diskriminimit racor, kundër diskriminimit të grave, për të drejtat e grave, për të drejtat e fëmijëve, për të drejtat e punëtorëve emigrant. Këto komitete ushtrojnë mbikëqyrje ndaj realizimit të lirive dhe të drejtave të njeriut të garantuara me marrëveshje ndërkombëtare.

Sistemi evropian i mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut bazohet në **KEDNJ** dhe në punën e vyeshme dhe shumë produktive të **GJEDNJ-së**. Për dallim nga mbrojtja paraprake, këtu ofrohet mbrojtja juridike në kuptimin e plotë të fjalës, sepse vendimet e **Gjykatës së Strasburgut** detyrojnë (lidhin) shtetin për të cilin është konstatuar se ka shkelur të drejtën dhe lirinë e caktuar. Procedura e mbrojtjes vihet në lëvizje me parashtresë (aplikacion), e cila përmban përshkrimin e cenimit të lirisë dhe të drejtës njerëzore. Për të paraqitur aplikacionin është e domosdoshme që paraprakisht të jenë shteruar mjetet e brendshme juridike - padia, ankesa, ankesa kushtetuese – dhe të plotësohen edhe kushtet tjera për lejueshmërinë e aplikacionit. Parashtresën mund ta paraqesin individët, grupet e individëve, kompanitë dhe organizatat joqeveritare, si dhe shtetet (aplikacioni apo parashtresa ndërshtetërore konform nenit 33 të KEDNJ-së), në një afat brenda gjashtë muajve nga plotfuqishmëria e vendimit në nivel nacional. Secila palë e paditur ka përfaqësuesin e vet, që quhet agjent, kurse procedura zhvillohet para gjykatësit të vetëm, kolegjit prej tre gjyqtarëve, kolegjit prej shtatë gjyqtarëve dhe kolegjin e madh ("Grand Chamber") prej shtatëmbëdhjetë gjyqtarëve. Ato shtete që kanë pranuar **GJEDNJ-në** si institucionin e përhershëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, konform Protokollit 11 (miratuar më 1994, hyrë në fuqi më 1998), Protokollit 14 (miratuar më 2004, hyrë në fuqi më 2010) propozojnë tre kandidatë për gjyqtarë, kurse **Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës** (AP), me shumicë votash zgjedh njërin prej tyre. Aktgjykimi i Kolegjit të Madh është i plotfuqishëm dhe juridikisht i detyrueshëm për shtetin, i cili ka për detyrim të ndërpres cenimin e të drejtave dhe lirive njerëzore të konstatuara me të dhe të kompensojë dëmin e shkaktuar ndaj të dëmtuarit. Në kuptimin e ngushtë të fjalës, aktgjykimi ka veprim vetëm ndaj palëve ("inter partes"), mirëpo me vendimet e **GJEDNJ-së**, për shkak të rëndësisë së tyre dhe thirrjes së **GJEDNJ-së** në to në mënyrë të vazhdueshme, joformalisht kanë statusin dhe fuqinë e precedentit ("stare decisis") dhe veprojnë edhe ndaj të gjithëve.

6. Disa nga liritë dhe të drejtat e njeriut

6.1. Liritë dhe të drejtat personale

Liritë dhe të drejtat personale u takojnë krejt njerëzve, si qenie njerëzore. Konsiderohen si të drejta burimore dhe më të rëndësishme, pa të cilat nuk do të kishin asnjë kuptim të drejtat e gjeneratave të mëpastajme. Bëhet fjalë për liri dhe të drejta themelore, nga të cilat praktikisht janë nxjerrë të drejtat politike, sociale, ekonomike dhe kulturore. Këto liri dhe të drejta i takojnë çdo individi, që është cilësi e lirive dhe të drejtave individuale, pa marrë parasysh nëse individi, në të njëjtën kohë, i takon ndonjë grupi të caktuar.

Sipas **objektit** apo **të mirës** që mbrojnë, këto liri dhe të drejta mund të grupohen në disa tërësi. Në grupimin e parë hyjnë të drejtat dhe liritë me të cilat mbrohet **integriteti fizik** i njeriut, siç janë: e drejta për jetë, liria personale, liria e lëvizjes dhe vendosjes, ndalimi i robërisë, punës së detyrueshme, tregtisë me robër, ndalimi i torturës dhe veprimit tjetër të dhunshëm. Në grupimin e dytë futen liritë dhe të drejtat personale me të cilat mbrohet **integriteti shpirtëror**, siç janë: dinjiteti njerëzor, e drejta për zhvillim personal, liria e mendimit, ndërgjegjes, fesë, besimit dhe shprehjes së mendimit, ndalimi i trajtimit përbuzës dhe mundimit psikik, ndalimi i mbajtjes në pozitë të nënshtruar përmes kërcënimit, shantazhit dhe mashtrimit. Së fundi, në grupimin e tretë grupohen liritë dhe të drejtat personale me të cilat mbrohet **privatësia**, siç janë: pacenueshmëria e banesës, fshehtësia e korrespondencës, mbrojtja e të dhënave personale, e drejta për martesë, privatësia e familjes, e drejta e vendosjes mbi lindjen e fëmijëve.

6.1.1. E drejta për jetë

E drejta për jetë është e drejtë elementare njerëzore. Kjo është një e drejtë fillestare, me të cilën në një lidhje të drejtpërdrejtë ose të afërt qëndrojnë krejt të drejtat dhe liritë tjera njerëzore. Liritë dhe të drejtat personale janë në marrëdhënie të drejtpërdrejtë me të drejtën për jetë dhe varen nga ajo.

E mira që mbrohet me të drejtën për jetë në kuptimin e ngushtë është vetë jeta, qenësia e qenies njerëzore, që fillon me lindje dhe zgjat deri në vdekje. E parë nga ky aspekt, të gjitha qeniet e gjalla njerëzore e realizojnë të drejtën për jetë. Cenimi i vetëm i kësaj të drejte do të thotë kryerje e vrasjes apo e ekzekutimit me vdekje. Në kuptimin më të gjerë të fjalës, e drejta për jetë nënkupton mbrojtjen më vëllimore dhe më gjithëpërfshirëse të jetës. Për realizimin e kësaj të drejte kërkohet aktivitet i shtuar i shtetit me qëllim të pengimit të privimit të njerëzve nga jeta, ndalimin e klonimit të njerëzve dhe kështu me radhë. Në kuptimin e gjerë të fjalës, e drejta për jetë përfshinë edhe të mira të tjera që mbrohen me të drejta personale: **liria** – jeta e lirë; **dinjiteti** – jeta me dinjitet njerëzor; **barazia** – ndalimi i mbajtjes së njerëzve në robëri apo gjendje tjetër të dhunshme; **fati** – zhvillimi i barabartë dhe i lirë i personalitetit; **subjektiviteti** – vendosja vetjake mbi të drejtat dhe detyrat.

Sipas praktikës së **GJEDNJ-së**, dallohen tri grupe detyrimesh që ka shteti nga shteti lidhur me mbrojtjen e këtij garancioni kushtetues. Së pari vjen detyrimi negativ – nga shteti kërkohet që mos të ndërmerr masa që çojnë në privim të kundërligjshëm nga jeta. Pas kësaj, së dyti, vjen detyrimi pozitiv i shtetit – ndërmarrja e masave efektive preventive (normative dhe praktike) për të penguar marrjen e jetës. Së fundi, shteti ka për detyrë që të ndjek dhe ndëshkoj penalisht çdo privim të kundërligjshëm nga jeta (represioni). Ndryshe konsiderohet si lëshim i organeve shtetërore kompetente për plotësimin e detyrimeve si më sipër për mbrojtje të së drejtës për jetë të personave që bien nën juridiksionin e tyre. Kjo tërheq më vete përgjegjësinë e shtetit për veprimin ose mosveprimin e organeve të veta.

Pyetja themelore që ngrihet lidhur me të drejtën për jetë ka të bëjë me atë nëse në shtet ekziston **dënimi me vdekje**, si sanksion kardinal, më i rëndë i mundshëm për kryesit e veprës penale. Nëse nuk

ekziston dënimi me vdekje, sepse është hequr apo nuk ka ekzistuar kurrë, atëherë e drejta për jetë është **e drejtë absolute**, përkatësisht e drejtë tërësisht e mbrojtur. Në shtete ku ekziston dënimi me vdekje, si një sanksion ligjërisht i përcaktuar, atëherë e drejta për jetë është **e drejtë relative**. Mbi këtë bazë ndahen shtetet që kanë dënimin me vdekje, e shqiptojnë dhe ekzekutojnë, dhe ato që nuk e kanë, por në vend të saj kanë përcaktuar dënimin me burgim. Kjo ndarje nuk është çështje që lidhet me zhvillimin demokratik të një vendi, sepse ekzistimi i dënimit me vdekje në shtetet e caktuara varet nga një sërë faktorësh të tjerë, siç janë: tradita, morali, kultura fetare dhe kultura e përgjithshme, shkalla e kriminalitetit dhe shpeshtësia e kryerjes së krimeve më të rënda, stabilitetit politik dhe kështu me radhë. Për këtë arsye, në disa shtete me traditë demokratike kushtetuese dhe me rend kushtetues stabil, siç janë: **SHBA**, **India** dhe **Japonia,** dënimi me vdekje ekziston dhe ekzekutohet, kurse në disa të tjera, siç janë vendet e Evropës, me përjashtim të Bjellorusisë, ky dënim nuk ekziston.

Fakti që shtetet, sot e kësaj ditë ndahen në ato që e kanë dhe të tjerat që nuk e kanë **dënimin me vdekje,** ka bërë që në aktet ndërkombëtare të OKB-së, e drejta për jetë të gëzojë një pozitë mjaft të posaçme. Kështu, ta zëmë, **DUDNJ-ja** flet për të drejtën e secilit për jetë (neni 3), kurse **PDCP-ja** mbi këtë të drejtë ka më shumë dispozita (neni 6). Në këtë kuptim, ky akt ndalon privimin arbitrar nga jeta, kurse dënimi me vdekje mund të përcaktohet vetëm për veprat më të rënda penale, sipas ligjit në fuqi në kohën e kryerjes së veprës (ndalimi i retroaktivitetit), dhe që mund të ekzekutohet vetëm mbi bazën e një aktgjykimi të formës së prerë. Ky dënim në asnjë rast nuk mund të shqiptohet dhe as të ekzekutohet ndaj personave nën moshën 18-vjeçare dhe grave shtatzëna. I dënuari me vdekje ka të drejtë të kërkojë falje apo zëvendësim të dënimit. Në fillim, me **KEDNJ** e drejta për jetë nuk ka qenë e normuar si e drejtë e pacenueshme, sepse dënimi me vdekje ka ekzistuar. Kusht i vetëm për shqiptimin dhe ekzekutimin e këtij dënimi në truallin evropian, fillimisht ka qenë që të jetë i përcaktuar me ligj. Me dispozitat fillestare, gjithashtu ka qenë i ndaluar privimi arbitrar nga jeta, përveç rasteve të ekzekutimit të aktgjykimit të formës së prerë mbi dënimin me vdekje, dhe ka qenë i përjashtuar privimi i kundërligjshëm nga jeta në rastet e mbrojtjes së nevojshme dhe nevojës së domosdoshme (me qëllim të mbrojtjes nga dhuna, me qëllim të privimit të ligjshëm nga liria, pengimit të ikjes, me qëllim të vënies së rendit dhe qetësisë dhe shtypjes së kryengritjes) (neni 2). Me **Protokollin 2** të **KEDNJ-së** (1983, ka hyrë në fuqi më 1985), nuk është hequr në tërësi **dënimi me vdekje**, për shkak se ai akoma ka mund të shqiptohet dhe ekzekutohet për vepra penale të kryera gjatë luftës dhe rrezikut të drejtpërdrejtë nga lufta. **Protokolli 2**, megjithatë, shënon një progres në drejtim të heqjes së dënimit me vdekje, gjë që ndodhë përfundimisht me **Protokollin 13** (2002, hyr në fuqi më 2003).

Në të drejtën e brendshme, **e drejta për jetë** garantohet me kushtetutë nacionale. Kushtetuta, megjithatë, nuk definon kuptimin e qenies njerëzore, momentin e krijimit të saj dhe as faktin nëse qenia njerëzore përfshinë edhe ata që akoma nuk kanë lindur.

Mbi bazën e garancioneve që ofrohen, zgjidhjet kushtetuese të shteteve mund të grupohen në disa grupe. Në grupin e parë hyjnë zgjidhjet kushtetuese që garantojnë të drejtën e çdokujt për jetë, duke përforcuar garancionin e tillë edhe me dispozita të tjera kushtetuese më periferike, siç janë dispozitat mbi ndalimin e dënimit me vdekje, ndalimin e privimit kundërligjor nga jeta dhe, së fundi, dispozitat mbi ndalimin e klonimit të njerëzve. Një grupim tjetër i shteteve, këtë formulim kësisoj të së drejtës për jetë e përplotësojnë me dispozitat kushtetuese mbi të drejtat e tjera personale, siç janë e drejta për liri personale, dinjitet, integritet fizik dhe psikik (që nënkupton ndalimin e ekzekutimit të dënimit trupor, shqiptimin e dënimeve mizore, nënçmuese dhe jonjerëzore, ndalimin e kërcënimit, shtrëngimit dhe torturës). Vlen të theksohet se **e drejta për jetë nuk duhet medoemos të jetë e garantuar**: për ekzistencën e saj, mund të kuptohet nga dispozitat tjera mbi liritë dhe të drejtat e njeriut. Kështu, ta zëmë, **Kushtetuta e Italisë** përcakton se "dënimi me vdekje nuk është i përcaktuar me ligj" (neni 27), në ndërkohë që e ajo garanton disa liri dhe të drejta të tjera personale. Një grup tjetër i shteteve, grupimi i tretë, identifikohet me zgjidhjet kushtetuese të **Ligjit Themelor të Gjermanisë** (**LTH)**, ku e drejta për jetë nuk garantohet dhe nuk ndalohet dënimi me vdekje, por sigurohet e drejta për dinjitet

dhe liri si dhe të drejta të tjera personale (nenet 1-6). Krahas këtyre zgjidhjeve kushtetuese, së fundi, e drejta për jetë garantohet dhe mbrohet edhe përmes përqafimit të marrëveshjeve dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare. Shtetet që përqafojnë këtë qasje nuk përbëjnë një grupim të veçantë sepse kjo qasje zakonisht shoqëron ndonjërën prej zgjidhjeve kushtetuese të sipërcekura.

Përveç dënimit me vdekje, që përfaqëson mënyrën e ligjshme të privimit nga jeta të një personi nga ana e shtetit, si çështje kontestuese lidhur me të drejtën për jetë lajmërohen edhe **e drejta për abortim** dhe **e drejta në eutanazi**. Abortimi është ndërprerje e shtatzënisë përmes shkatërrimit të fetusit (frytit). E drejta për abortim, përkatësisht e drejta për ndërprerje të shtatzënësisë hyn në sferën e privatësisë së gruas, por nuk guxon të kuptohet si masë për planifikim të familjes apo mjet kontraceptiv. Pyetja themelore që shtrohet është nëse me këtë veprim cenohet e drejta për jetë e fëmijës akoma të palindur? Nëse përgjigja është pozitive, atëherë kjo bie ndesh me një të drejtë tjetër kushtetuese – të drejtën e gruas për të vendosur mbi lindjen. Pjesa më e madhe e shteteve kanë një zgjidhje të ndërmjetme kushtetuese – lejojnë abortimin deri në një shkallë të caktuar të moshës së fetusit (frytit) dhe për arsye shëndetësore. Kjo nënkupton se kushtetuta garanton të drejtën për jetë, në parim, deri në momentin kur kjo e drejtë nuk ndeshet me të drejtën e gruas për privatësi. E drejta e qenies njerëzore që nuk ka lindur akoma nuk mbrohet dhe nuk ka epërsi ndaj të drejtës së gruas për privatësi. Kjo nënkupton që ligjvënësi ka lirinë e diskrecionit apo lirinë vlerësimit për arritjen e një baraspeshe të drejtë në mes të drejtës së gruas për të vendosur dhe privatësi, në njërën anë, dhe interesit publik për mbrojtje të qenies së palindur njerëzore, në anën tjetër. E drejta për abortim, përkatësisht e drejta për ndërprerje të shtatzënësisë hyn në sferën e privatësisë së gruas, por nuk guxon të kuptohet si masë për planifikim të familjes apo mjet kontraceptiv.

Eutanazia nënkupton privimin nga jeta të një të sëmuri që nuk ka shërim, me pajtimin e saj/tij apo të familjes së saj/tij, me qëllim të pengimit të vuajtjeve të mëtejme. Nganjëherë quhet edhe privim nga jeta për mëshirë. Kundërshtarët e eutanazisë e konsiderojnë atë si cenim të së drejtës së patjetërsueshme për jetë, kurse përkrahësit e saj konsiderojnë se e drejta për jetë përfshinë edhe të drejtën për dinjitet, mbrojtje të integritetit fizik dhe psikik nga dhimbjet dhe vuajtjet dhe, në fund, përbën një veprim sipas mëshirës ndaj një të sëmuri që nuk ka shërim.

6.1.2. Liria personale

Liria personale (liria e personalitetit, e drejta për liri dhe personalitet) është presupozim i lirive dhe të drejtave të tjera. Pa liri të plotë qytetarët nuk mund të realizojnë shumicën e lirive dhe të drejtave të tjera. Ajo, megjithatë, nuk është një e drejtë absolute, sepse varet nga liritë dhe të drejtat e të tjerëve, por edhe nga marrëdhëniet politike dhe gjendjen ekonomike në shoqëri.

Liria personale përfshinë një mori të të drejtave, lirive, mbrojtjeve dhe ndalesave. Kjo e bën një koncept me përmbajtje të ndërlikuar, që ngërthen përbërësit tjerë, siç janë: liria dhe siguria e personalitetit, liria e lëvizjes dhe vendosjes, ndalimi i skllavërisë dhe formave të tjera të jolirisë (tregtia me njerëz, puna e detyrueshme etj.), mbrojtja e lirisë personale para organeve të pushtetit, në veçanti në procedurë penale, e deri të veprimi ndaj personave të privuar nga liria. E drejta për liri personale më së shumti është e lidhur me të drejtën për lirinë e lëvizjes – njerëzit që nuk janë të lirë kurrë nuk kanë lirinë e lëvizjes, e cila, si pjesë e lirisë personale, rregullohet në mënyrë të veçantë. Ky rregullim i lirisë personale si një **vlerë kushtetuese** mund të koncentrohet në të drejtën për liri dhe siguri të personalitetit. Liria dhe siguria e personalitetit përfshinë: ndalimin e arrestimit arbitrar dhe kushtet e lejimit të privimit nga liria, të drejtat e veçanta dhe statusi i posaçëm të personave të privuar nga liria dhe, veçanërisht, rregullimi i paraburgimit si formë preventive e privimit nga liria (para provimit të fajësisë).

Nuk është e lehtë të definohet liria si një e drejtë natyrore e njeriut. Më lehtë është të definohet **joliria**, si antipod i saj. Janë disa forma të manifestimit të **jolirisë**, ta zëmë: skllavëria, puna e detyrueshme,

robëria dhe çdo formë tjetër e kundërt me lirinë. E definuar nga këndi pozitiv, liria personale mund të përcaktohet si mundësi për të bërë atë që dëshirohet. Në këtë kuptim, liria është gjendje në të cilën njeriu mund të shpreh botën e vet të brendshme, vullnetin vetjak. Liria e personalitetit është një hapësirë individuale, e veçantë por edhe e ndryshme në të njëjtën kohë për secilin individ. Kjo sepse ajo varet nga edukata, arsimimi, prirjet dhe interesimet, talenti dhe nga cilësi të tjera personale dhe pavarësia ekonomike. Hapësira e lirisë personale nuk është një hapësirë e pakufizuar ngaqë kufizohet nga liritë personale të individëve të tjerë. Shih për këtë, liria si mundësi për të bërë ajo që dëshirohet nuk është e realizueshme dhe e qëndrueshme në një shoqëri të lirë, demokratike, për shkak se një liri e tillë e një individi do të përfaqësonte joliri për tjetrin. Me qëllim të pengimit të trazimit të parimit kushtetues mbi barazinë juridike dhe faktike të njerëzve, liria personale duhet të rregullohet dhe kufizohet me norma juridike.

Teoricienët liberalë që kanë ndërtuar themelet ideologjike të kushtetutave të para, nuk e kanë ndarë lirinë nga konstitucionalizmi dhe të drejtat e njeriut, por e kanë trajtuar si kusht për realizimin e tyre. Heqja dorë nga liria nënkupton heqje dorë nga njeriu.[28] Liria si ideal dhe si e drejtë përmendet edhe në kushtetutat e para të shkruara (**Kushtetuta e SHBA-së** ka për qëllim që të sigurohen "të mirat e lirisë"; **Kushtetuta e Francës e vitit 1791** i garanton çdo kujt lirinë e lëvizjes dhe lirinë nga burgimi), deklaratat që i kanë parapri kushtetutave të para të shkruara, por edhe në aktet e hershme kushtetuese. Kështu, **Karta e Madhe e Lirive** e vitit 1215, që sot është në fuqi në Britaninë e Madhe, thotë se mbreti garanton lirinë njerëzve të lirë dhe atë, mes tjerash, lirinë nga burgosja joligjore dhe lirinë e lëvizjes (nenet 39 dhe 43). Për këtë arsye mund të thuhet se liria personale ka ekzistuar çdo herë në një masë të caktuar, por edhe anasjelltas – ka qenë e kufizuar çdo herë në një masë të caktuar, përmes ligjit, zakonit apo moralit.

Liria personale është objekt i marrëveshjeve, instrumenteve dhe dokumenteve ndërkombëtare. **DUDNJ-ja** garanton të drejtën për liri, ndalon robërinë, pozitën e nënshtrimit dhe tregtinë me njerëz, mbron nga burgimi, arrestimi dhe dëbimi arbitrar, garanton gjykimin e drejtë dhe të paanshëm (nenet 3, 4, 9-11). **PDCP-ja** i garanton çdo individi të drejtën për liri dhe siguri të personalitetit, ndalon robërinë dhe tregtinë me njerëz, mbajtjen në robëri dhe punë të detyrueshme apo me dhunë, garanton lirinë nga burgimi, arrestimi arbitrar, rregullon procedurën me personin e privuar nga liria, ndalon robërinë për shkak të borxhit (nenet 8-11). Garancione të ngjashme përmban KEDNJ-ja: ndalon robërinë dhe punën e detyrueshme ose me dhunë, të drejtën në liri dhe siguri që nënkupton mundësinë për burgim vetëm sipas ligjit dhe kushteve të KEDNJ-së, pastaj garancionet e gjykimit të drejtë dhe të paanshëm dhe dënimit sipas ligjit (nenet 4-7). Ekzistojnë edhe akte të posaçme ndërkombëtare që rregullojnë vetëm një aspekt të lirisë personale, siç janë: **Konventa plotësuese e OKB-së për heqjen e robërisë, tregtisë me njerëz dhe përvojave e praktikave të ngjashme me robërinë** (1956, për herë të parë një konventë e tillë është miratuar në vitin 1926), **Konventa e Këshillit të Evropës për luftën kundër tregtisë me njerëz** (2005), **Konventa e OKB-së kundër torturës dhe dënimeve e procedurave të tjera mizore, çnjerëzore dhe degraduese** (1984), **Konventa e Këshillit të Evropës për pengimin e torturës dhe dënimeve e procedurave të tjera mizore, çnjerëzore dhe degraduese** (1987), me të cilën themelohet **Komiteti për pengimin e torturës dhe veprimeve të tjera të palejueshme.**

Lirinë personale e garantojnë kushtetutat nacionale dhe atë së bashku me të drejtat e personalitetit. Kushtetutat në të shumtën e kohës konfirmojnë dispozitat e përmbajtura në marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare, por edhe rregullojnë lirinë dhe të drejtat e personalitetit në mënyrë më të detajuar në respektim të rrethanave konkrete të shtetit përkatës.

E drejta për lirinë personale garantohet në rend të parë përmes sigurisë personale dhe vënies së kufizimeve kushtetuese dhe caktimit të kushteve të qarta për privim nga liria. Kushtetutat ndalojnë gjend-

[28] John C. Hall, *Rousseau: Totalitarian or Liberal*? (Columbia University Press: New York, 1956) fq. 99.

jet e jolirisë, siç janë robëria dhe pozita e nënshtrimit të dhunshëm të njeriut. Në veçanti, kushtetutat përcaktojnë garancione për mbrojtjen dhe ruajtjen e lirisë personale, duke ua njohur individëve të drejtat e caktuara në procedurat para organeve të pushtetit, posaçërisht para gjykatave. Këtu bën pjesë e drejta e qytetarit për t'iu drejtuar pushtetit (organeve të administratës, gjykatës, gjykatës kushtetuese, avokatit të popullit) me qëllim të mbrojtjes së lirisë personale. Kjo e drejtë ka kuptim vetëm nëse ekzistojnë garancionet kushtetuese dhe ligjore për veprim të drejtë dhe të ligjshëm të organeve të pushtetit: e drejta për mbrojtje, ankesë, gjyq kompetent dhe të pavarur, ndalimi i arrestimit joligjor dhe normimi i institutit të paraburgimit, prezumimi i pafajësisë, legaliteti i veprës dhe sanksionit, karakteri personal i përgjegjësisë penale, efektit i çështjes së gjykuar (**res judicata** dhe **ne bis in idem**). Në liri dhe siguri personale hyjnë edhe garancionet e veprimit me dinjitet ndaj individit të privuar nga liria, në veçanti ndalimi i torturës, që gjithashtu është objekt i rregullimit kushtetues.

Si pjesë e lirisë personale janë të **drejtat e personalitetit** të secilit person të cilat mbrohen në mënyrë të veçantë në shtetet bashkëkohore. Përveç lirisë personale, përfshijnë edhe emrin e mirë, nderin dhe autoritetin, cenimi i të cilave shkakton **dhimbje shpirtërore**. Me këtë kategori nënkuptohen të drejtat që janë të natyrshme për personin dhe që fitohen me lindje. Të drejtat e personalitetit të personave juridikë janë ato të drejta që burojnë nga natyra dhe qëllimi shoqëror i personave të tillë. Mbrojtja e tyre më së shpeshti bëhet përmes institutit të dëmit jomaterial, që ka tri forma: **biologjike** (për shkak të cenimit të trupit), **morale** (për shkak të cenimit të psikikës) dhe **ekzistenciale** (për shkak të cenimit të të gjitha të drejtave të personalitetit, përkatësisht për shkak të cenimit të **shpirtit njerëzor**). Çdo cenim i të drejtave të personalitetit përbën dëm jomaterial. Dëmi jomaterial për **dhimbjet shpirtërore**, forma ekzistenciale e dëmit, që shkaktohet nga privimi i paligjshëm i lirisë, paraqet një formë unike të dëmit dhe përfshinë të gjitha pasojat e dëmit jomaterial që lidhen për personin e dëmtuar nga privimi i paligjshëm i lirisë (humbja e lirisë në mënyrë të kundërligjshme).

6.1.3. Liria e lëvizjes

Kjo liri përmbajtësisht qëndron më së afërmi me lirinë personale, sepse individi jo i lirë nuk ka mundësi për të lëvizur lirisht, duke qenë i kufizuar në një hapësirë apo vend të caktuar. Privimi nga liria në të njëjtën kohë është kufizim i lirisë së lëvizjes. Në kushtetutat bashkëkohore, megjithatë, liria e lëvizjes ndahet dhe rregullohet në mënyrë të posaçme si e drejtë e çdo personi për të lëvizur dhe për të zënë vend, si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Liria e lëvizjes dhe e vendosjes normohet me pikë referimi territorin e shtetit. Ajo përfshinë lëvizjen brenda territorit shtetëror (liria e lëvizjes), zgjedhjen e vendit të qëndrimit dhe vendit të banimit (liria e vendosjes), daljen nga shteti dhe kthimi në të ("e drejta në pasaportë" apo në dokument udhëtimi). Marrë parasysh natyrën e saj, liria e lëvizjes dhe vendosjes nuk është një e drejtë e pakufizuar, dhe as që mund të jetë e tillë. Në rend të parë kufizohet nga liritë dhe të drejtat e të tjerëve, kështu që, ta zëmë, pacenueshmëria e banesës, shtëpisë apo posedimit kufizon lirinë e lëvizjes, sepse nuk mund të realizohet në posedimet private të tjetrit. **Liria e lëvizjes** dhe vendosjes kufizohet për arsye juridikisht të përcaktuara, që hyjnë në kategorinë e interesit publik, siç janë: siguria e shtetit dhe qytetarit, mbrojtja e rendit kushtetues, pasuria dhe shëndeti individëve, luftimi kriminalitetit. Rregullativat "teknike" që normojnë lëvizjen e njerëzve, siç janë vozitja në anën e djathtë, ecja në trotuar, kalimi për këmbësor, rregullimi komunikacionit me semaforë dhe rregulla të tjera si këto, nuk konsiderohen kufizime të lirisë së lëvizjes. Kjo është kështu për shkak se, pikërisht si të tilla, rregullat në fjalë janë të domosdoshme për realizimin e përditshëm të lirisë së lëvizjes për të gjithë. Në disa situata, në veçanti kufizohet **liria e lëvizjes për të huajt**, siç është afrimi dhe vizita e objekteve ushtarake, zonat industriale, rripit kufitar etj.

Liria e vendosjes përfshinë **të drejtën në vendqëndrim** (vendosja e përkohshme) dhe **të drejtën për vendbanim** (domicil apo vendosjen e përhershme). Çdo kush ka të drejtë për të vendosur për vendqëndrimin dhe vendbanimin e vet. Liria e vendosjes garantohet brenda territorit shtetëror. Kjo

liri është parakusht për realizimin e të drejtave të tjera. Kështu, ta zëmë, për realizimin e të drejtave zgjedhore, të drejtave sociale, ekonomike dhe kulturore individi duhet të jetë i vendosur në një shtet. Kjo liri gjithashtu është e lidhur me të drejtën e strehimit (azilit): kur të huajve apo apatridëve (personave pa shtetësi) iu rrezikohet siguria për shkak të racës, fesë, bindjeve politike dhe cilësive të tjera personale, duhet të mundësohet që ata të hyjnë në territorin e shtetit. Dhe e kundërta – të huajve kjo liri u merret në momentin e shqiptimit ndaj tyre të masës së **dëbimit (përzënies)**. Kjo masë ka karakter mbrojtës dhe shqiptohet krahas sanksionit penal (dënimit me burg ose me të holla). Shqiptimi i kësaj mase duhet të matet mirë nga gjykata, duke marrë parasysh peshën e veprës së kryer nga njëra anë dhe, në anën tjetër, të gjitha rrethanat tjera të rastit konkret. Kjo bëhet me qëllim të vlerësimit nëse qëllimi i dënimit (sanksionimit) të të huajve ka mundur të arrihet në një mënyrë tjetër, me një masë tjetër më të butë (ta zëmë, vetëm me dënim me të holla).

Liria e hyrjes dhe daljes nga shteti nënkupton posedimin e dokumentit të udhëtimit, e cila mundëson lëshimin e territorit shtetëror dhe kthimit të serishëm aty. Kjo liri mund të kufizohet me kushtet e vëna nga shteti tjetër, që kërkojnë posedimin e një leje të posaçme për hyrje në shtet (**viza**).

DUDNJ-ja garanton për të gjithë lirinë e lëvizjes dhe lirinë e zgjedhjes së vendbanimit, të drejtën për të lëshuar shtetin vetjak apo shtetin tjetër, përfshirë të drejtën për t'u rikthyer në shtetin e vet (neni 13). Në **PDCP**, krahas garantimit të lirisë së lëvizjes dhe lirisë së vendosjes, jepen kushtet që duhen plotësuar për kufizimin e këtyre lirive. Arsyet duhet të jenë të përcaktuara me ligj dhe në pajtim më të drejtat tjera nga **PDCP-ja**. Kufizimi i këtyre lirive, ndërkaq, lejohet vetëm nëse bëhet fjalë për mbrojtjen e sigurisë nacionale, rendit publik, shëndetit apo moralit publik, lirive dhe të drejtave të të tjerëve (neni 12). **KEDNJ-ja** nuk ka normuar **lirinë e lëvizjes** në tekstin fillestar. Këtë e ka bërë me **Protokollin 2** (neni 2), i cili garanton lirinë e lëvizjes me kushtin e vendqëndrimit të ligjshëm në shtet. Me KEDNJ janë përcaktuar arsyet për kufizimin e kësaj lirie, të cilat duhet të jenë të përcaktuara me ligj dhe të jenë të domosdoshme në një shoqëri demokratike, dhe kanë të bëjnë me interesin e sigurisë nacionale ose sigurisë publike, ruajtjen e rendit publik, pengimin e kriminalitetit, mbrojtjen e shëndetit, moralit, lirive dhe të drejtave të tjerëve.

Liria e lëvizjes dhe vendosjes garantohet me kushtetuta nacionale, kurse më afër normohet me ligje të tjera, siç janë ligjet mbi vendqëndrimin dhe vendbanimin, të huajt, azilin etj. Kushtetutat përcaktojnë arsyet për të cilat mund të kufizohet liria e lëvizjes dhe vendosjes. Ato kryesisht kanë të bëjnë me sa vijon: mbrojtjen e shtetit, mbrojtja e rendit publik, epidemia dhe sëmundjet ngjitëse etj. Arsyet për kufizim të lirisë së lëvizjes dhe vendosjes nuk guxojnë të jenë të natyrës politike dhe ideologjike dhe as të mbështeten në cilësitë personale të individëve, siç janë: nacionaliteti, feja dhe besimi, gjinia, raca, mosha dhe kështu me radhë.

6.1.4. Liria e mendimit dhe shprehjes

Me lirinë e shprehjes dhe mendimit mbrohet integriteti shpirtëror i personalitetit. Për këtë arsye, këtë duhet radhitur në grupin e lirive dhe të drejtave të personale. Manifestimi publik i mendimit, megjithatë, mund të cilësohet edhe si e drejtë politike dhe atë si një e drejtë kryesore politike, e cila nënkupton manifestimin e lirë të qëndrimeve politike. Kjo e drejtë duhet të lidhet edhe me një të drejtë tjetër – të drejtën për dërgim të parashtresave dhe ankesave organeve shtetërore dhe trupave të tjerë publikë dhe për marrje të përgjigjeve në to.

Brenda lirisë së mendimit dhe shprehjes mund të dallohen dy procese dhe veprime. I pari është vetëm mendimi si proces i brendshëm psikik, si një cilësi e çdo qenie të arsyeshme. Sipas natyrës së vet mendimi është një aktivitet i brendshëm i njeriut që nuk mund të kufizohet me norma juridike. Për norma, mendimi ngelet i panjohur. Procesi i mendimit ndodhë (dhe zgjatë) para ose njëkohësisht me shprehjen e mendimit, që paraqet njohjen e botës së jashtme me qëndrimet dhe idetë vetjake apo të tjerëve. Men-

dimi i shprehur me gojë, shkrim, pamje, muzikë etj., mund të ndikojë tek të tjerët. Në këtë mënyrë liria e mendimit dhe shprehjes kalon në lirinë politike, por me kusht që publikisht të shprehet qëndrimi apo ideja e dhënë (ta zëmë, kritika ndaj pushtetit).

Mënyra më e shpeshtë e shprehjes së mendimit është me gojë apo gojarisht. Me fjalime publike shprehen idetë, qëndrimet, transmetohen informatat dhe lajmërimet, me qëllim të informimit të dëgjuesve dhe ndikimit në mendimet e tyre. Liria e fjalës së lirë e ka një kufizim përgjithësisht të pranuar, që ka të bëjë me **fjalimin urrejtjes**. Ky lloj i fjalimit është i ndaluar dhe praktikisht kufizon lirinë e fjalës publike, duke vënë kufijtë deri ku folësi mund të shkojë me shfaqjen e ideve dhe mendimeve, të cilat nuk mund të cilësohen si fjalim i urrejtjes dhe cenim i lirive dhe të drejtave të tjerëve. Në këtë kuptim, përvojat e vendeve janë të ndryshme. Kështu, ta zëmë, liria e fjalës publike është më e gjerë në SHBA, në krahasim me Evropën; në Londër ekziston një cep apo pjesë në parkun e madh londinez, i njohur si **Këndi Hajd Park i Folësve** ("Hyde Park's Speakers' Corner"), i cili merret si simbol i fjalës së lirë publike. Ngjashëm me të janë formuar cepat e fjalës së lirë në ish-kolonitë britanike, por çdo herë nën mbikëqyrjen e shtetit sepse jo çdo lloj i fjalimit është i lejuar, siç janë fjalimet që shajnë e fyejnë rënd moralin publik, nxisin urrejtje racore, fetare, gjinore dhe tjetër.

Shprehja e mendimit mund të jetë në formën e krijimtarisë shkencore ose artistike. Këtu hyjnë veprat shkencore dhe artistike, krijimtaria e arteve pamore, skulptura, ndërtimtaria dhe arkitektura, veprat muzikore etj. Mënyra e shprehjes së mendimeve që kanë ndikim politik bëhet kryesisht përmes medies. Ndikimin e madh të deridjeshëm të shtypit e kanë tejkaluar mediet elektronike, radio, televizioni dhe, çdo ditë e më shumë, **interneti**.

Për dallim nga **mendimet**, të cilat ngelin të pashfaqura, shprehja e mendimit me të drejtë mund të kufizohet. Arsyet për kufizim të lirisë së shprehjes kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesit të përgjithshëm apo interesit të të tjerëve, përkatësisht me rrezikimin e lirive dhe të drejtave të të tjerëve për shkak të nxitjes së urrejtjes racore ose fetare apo nëse rrezikohet siguria e shtetit përmes thirrjes për rrënim të dhunshëm të rendit kushtetues.

DUDNJ-ja garanton të drejtën për lirinë e mendimit dhe shprehjes për secilin individ. Kjo liri përfshinë mbrojtjen nga shqetësimi për shkak të mendimeve të shprehura dhe të drejtën për të kërkuar, marrë dhe shpërndarë informata dhe ide përmes cilitdo mjet komunikimi, brenda dhe jashtë shtetit (neni 19). Edhe **PDCP-ja**, me normimin e lirisë së mendimit, në të vërtetë normon lirinë e shprehjes së mendimit, në formën me gojë, me shkrim, përmes shtypit ose në formë artistike. Në parim, secili individ gëzon këtë liri dhe askush nuk mund të shqetësohet për mendimin e shprehur. Liria e shprehjes së mendimit, megjithatë, nuk përfaqëson një të **drejtë absolute**, sepse me ligj mund të kufizohet, me qëllim të respektimit të dinjitetit dhe të drejtave të të tjerëve, mbrojtjes së sigurisë shtetërore, rendit publik, shëndetit dhe moralit (neni 19). Në veçanti ndalohet shprehja e mendimit me të cilin avokohet lufta, urrejtja nacionale, racore, fetare ose tjetër dhe nxitet diskriminimi, armiqësia e dhuna (neni 20). **KEDNJ-ja** e normon lirinë e mendimit së bashku me lirinë e ndërgjegjes, fesë dhe besimit, duke e veçuar posaçërisht lirinë e shprehjes. Secili individ gëzon lirinë e shprehjes, e cila përfshinë si mendimin ashtu edhe marrjen dhe komunikimin e informacioneve dhe ideve. Këtu shteti nuk mund të përzihet, por mund t'i përcaktojë kushtet dhe kriteret për marrjen e lejes për punën e medieve. Kjo liri mund të kufizohet nëse një gjë e tillë është e domosdoshme për një shoqëri demokratike dhe në interes të: sigurisë nacionale, integritetit territorial, pengimit të çrregullimeve të rënda dhe kriminalitetit, mbrojtjes së shëndetit, moralit, autoritetit, dinjitetit dhe të drejtave të tjetrit, mbrojtjes së privatësisë, ruajtjes së pavarësisë dhe autoritetit të gjyqit. Nëse këto cenime ndodhin, shkelësit mund të ndëshkohen sipas ligjit (neni 10).

Në kushtetuta garantohet liria e mendimit dhe shprehjes së mendimit dhe caktohen arsyet për kufizim, në rastet konkrete, të lirisë së shprehjes. Këto arsye mëpastaj konkretizohen tutje me ligj, sipas autorizimit kushtetues. Liria e mendimit dhe shprehjes kufizohet në praktikë edhe për arsye të tjera, që nuk

janë të përcaktuara me norma juridike. Ato arsye lindin si pasojë e **autocensurës** që shkaktohet nga frika e veprimit të personave të tretë të fuqishëm. Të tilla janë rastet që kanë të bëjnë, ta zëmë, me frikën nga kritika e punëdhënësit apo eprorit nga ana e punëtorëve, kritika e studentit apo nxënësit ndaj profesorit, kritika e palës në punën e gjyqtarit apo zyrtarit tjetër publik dhe kështu me radhë. Çdo herë ekzistojnë njerëz më të dobët, mbrojtja e të cilëve nga shteti dhe autoritetet publike është e vaktë dhe joefektive.

Në mënyrë të tërthortë, përmes të drejtave të tjera kushtetuese, kushtetutat garantojnë lirinë e shprehjes së mendimit, ta zëmë, përmes lirisë së krijimit shkencor dhe artistik apo lirisë së tubimit.

6.1.5. Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë

Në thelb, kjo liri në diskursin e përditshëm ka të bëjë me lirinë e fesë. Në emërtim dhe në praktikë, megjithatë, kjo liri përbën një tërësi me lirinë e mendimit dhe ndërgjegjes. Kjo liri është e domosdoshme për të pasur një pikëpamje apo një qëndrim moral mbi botën që na rrethon, përfshirë dhe pikëpamjen lidhur me atë nëse besojmë ose jo në një zot. Liria e fesë, historikisht shikuar, meriton të veçohet si një liri e posaçme, si një garancion shumë specifik kushtetues, për shkak se përkatësia fetare ka qenë dhe ngelet akoma arsye e shkeljes së rëndë të lirive dhe të drejtave njerëzore, përfshirë mohimin e të drejtës për jetë (raste konkrete të kohëve të fundit janë: gjenocidi ndaj myslimanëve në **Bosnje – Hercegovinë** në vitin 1995, myslimanëve **Rohinga** në **Mijanmar** në vitin 2017, shkatërrimi sistematik i identitetit të myslimanëve në provincën veriperëndimore kineze **Xinjiang** etj.).

Liria e fesë është ngushtësisht e lidhur me statusin juridik të kishës dhe bashkësive të tjera fetare. Numri më i madh i shteteve të sotme pranojnë lirinë e fesë, në ndërkohë që përgjatë historisë kjo nuk ka qenë kështu. Edhe sot ekzistojnë pozicione të ndryshme zyrtare lidhur me fenë. Në këtë kuptim, shtetet qëndrojnë në dy anë të skajshme. Në njërin skaj janë shtetet, të pakta në numër, të cilat me kushtetutë definohen si **ateiste** (ateizmi shtetëror i majtë), në të cilat ekziston një qëndrim shpërfillës dhe mohues, deri armiqësor, ndaj feve. Këtu ideologjia zyrtare nuk i pranon si të tilla (**Kina** dhe **Koreja Veriore** aktualisht, Shqipëria e kohës së Enver Hoxhës dikur etj). Në skajin tjetër janë shtetet fetare (teokratike), në të cilat zyrtarisht sanksionohet me kushtetutë vetëm një fe dhe të tjera ndalohen (**Arabia Saudite**, **Irani**, **Vatikani** etj).

Sipas marrëdhënies që kanë me kishën, përkatësisht fenë, shtetet tjera mund të ndahen në disa grupe. Në një grup hyjnë ato ku ekziston një kishë, përkatësisht një religjion shtetëror, mirëpo lejojnë edhe religjionet tjera (**Britania e Madhe**, **Greqia** etj.). Në grupin tjetër hyjnë shtetet në të cilat kishat dhe religjionet e caktuara kanë një status të posaçëm, por jo statusin e kishës, përkatësisht të religjionit shtetëror, kurse të tjerat kanë statusin e zakonshëm (ta zëmë, **Hungaria**). Krejt në një grup tjetër janë shtetet që në tërësi janë sekulare, ku të gjitha kishat, bashkësitë fetare dhe besimet kanë status të personave juridik privat me status të barabartë (ta zëmë, **SHBA** dhe **Australia**).

Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë përfshinë të drejtën e besimit në një Zot, të drejtën e mosbesimit në një Zot, të drejtën e shpërfaqjes së fesë dhe besimit, të drejtën e mosdeklarimit lidhur me bindjet fetare dhe besimin dhe, në fund, të drejtën e ndryshimit të fesë dhe besimit. Në disa vende, përpjekjet dhe veprimet për qëllim të ndryshimit të fesë, **prozelitizmi**, ndalohen në mënyrë shprehimore (ta zëmë **Greqia** dhe disa vende myslimane). Për ata që besojnë në një zot, liria e fesë përfshinë kryerjen e riteve fetare (lutjet dhe ritet tjera), shënimin e festave fetare, ndjekjen e shkollave fetare, mësimin e fesë, kundërshtimin e ndërgjegjes, ndalimin e diskriminimit fetar dhe të keqpërdorimit të fesë për qëllime politike dhe të tjera. Liria e fesë është e kufizuar edhe me respektimin zakoneve apo normave fetare, ashtu që shkelësit e tyre mund të izolohen (**ekskomunikohen**) nga bashkësia fetare. Kjo liri, në rrethanat e caktuara nuk është vetëm liri e çdokujt, që varet nga mendimi dhe ndërgjegjja vetjake, por mund të jetë edhe detyrim.

Pjesë e kësaj lirie është **kundërshtimi i ndërgjegjes**. Kjo është një e drejtë, thelbi i së cilës konsiston në atë që individët, për shkak të fesë apo konsideratave të dhëna morale, mund të kryejnë, por edhe të rezistojnë (moskryejnë) një detyrim juridik. Kundërshtimi i ndërgjegjes më së shpeshti lidhet me të drejtën që detyrimi ushtarak të kryhet pa bartur armë. Kundërshtimi i ndërgjegjes mund të shikohet edhe më gjerësisht, si moszbatim i detyrimit apo mosveprim sipas ndërgjegjes vetjake në çështjet e abortimit, eutanazisë apo ekzekutimit legal të dënimit me vdekje.

Në **DUDNJ**, e drejta në lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë i takon çdo kujt. Kjo përfshinë lirinë për ndryshim të fesë, që vetë ose në shoqëri me të tjerët të shfaqet besimi individual fetar dhe tjetër, dhe atë përmes: studimit të fesë, respektimit të fesë dhe besimit, kryerjes së shërbimit dhe riteve fetare (neni 18). **PDCP**-ja në mënyrë të ngjashme definon lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, mirëpo, për dallim nga **DUDNJ**-ja, këtu normohen edhe arsyet për shkak të të cilave mund të kufizohet kjo liri. Ato arsye mund të jenë vetëm ato që shprehimisht i ka përcaktuar ligji dhe që janë të domosdoshme me qëllim të mbrojtjes së sigurisë nacionale, rendit, shëndetit dhe moralit dhe lirive e të drejtave të personave të tjerë. Në mënyrë të veçantë ndalohet dhuna që ushtrohet me qëllim të shkeljes së lirisë së fesë, kurse prindërve u jepet liria për të siguruar që fëmijët e tyre do të marrin edukim fetar dhe moral në pajtim me bindjet që kanë (neni18). **KEDNJ-**ja gjithashtu rregullon lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, në një mënyrë shumë të ngjashme me **DUDNJ**. Liria e ushtrimit të fesë mund të kufizohet me arsye të vëna në ligj, që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike, ku bëjnë pjesë: interesi i sigurisë publike, mbrojtja e rendit publik, shëndetit dhe moralit, dhe mbrojtja e lirive dhe të drejtave të të tjerëve (neni 9).

Në kushtetua, liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë rregullohet në vartësi të asaj se çfarë marrëdhënie kanë shtetet me kishën dhe bashkësitë fetare dhe të besimit, përkatësisht nëse shteti është ateist, fetar apo laik (sekular). Në këtë kuptim, kjo liri nuk garantohet në shtete ateiste, feja e caktuar apo besimi është ideologji zyrtare në shtetin fetar apo, më së shpeshti, liria e fesë garantohet me kushtetutë si **e drejtë njerëzore** dhe si **një çështje private e individit** në një **shtet laik**.

6.1.6. E drejta e privatësisë

Më të drejtën e privatësisë nënkuptohen një mori të drejtash personale që mbrojnë sferën private të personit: **jeta private**, **vendbanimi**, **komunikimet** (korrespondenca), **familja**, të **dhënat personale**. Me këto të drejta, që përbëjnë privatësinë si kategori kushtetuese, mbrohet dinjiteti dhe integriteti i individit dhe i njerëzve të afërt me të. Në shtetet bashkëkohore janë imponuar dy lloje të arsyeve për shkak të të cilave ka ardhur deri te ngushtimi i të drejtave të privatësisë, shkelja dhe zhvlerësimi i tyre. Një arsye ka të bëjë me sigurinë e shoqërisë, shtetit, institucioneve, grupimeve të njerëzve apo individëve, të cilat paraqiten si bazë për ngushtimin e sferës së privatësisë. Si arsye e dytë jepet komunikimi i pandërprerë dhe shpejtësia e këmbimit të informatave (në kohë reale), ashtu që të dhënat që formojnë sferën private shndërrohen në të dhëna publike ose gjysmë publike, të qasshme për çdo kënd.

Aktet më të rëndësishme mbi të drejtën e privatësisë e rregullojnë atë së bashku, në një nen të vetëm. **DUDNJ**-ja (neni 12) dhe **PDCP**-ja (neni 17) ndalojnë përzierjen arbitrare ose të kundërligjshme në jetën private të kujtdo qoftë, familje, banesë, korrespondencë, si dhe sulmet në nderin dhe autoritetin e njerëzve. **KEDNJ**-ja i garanton secilit respektimin e jetës private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës. Autoritetet publike nuk guxojnë të përzihen në jetën private dhe familjare të individëve, përveç nëse një gjë e tillë është në interes të sigurisë ose dobisë ekonomike të shtetit, me qëllim të pengimit të çrregullimeve të rendit apo të kriminalitetit, mbrojtjes së shëndetit, moralit, lirive dhe të drejtave të të tjerëve. Këto arsye duhet të jenë të përcaktuara me ligj dhe të domosdoshme në një shoqëri demokratike (neni 8).

Pacenueshmëria e banesës është pjesë e të drejtës në privatësi, me të cilën mbrohet posedimi privat në të cilën njeriu qëndron dhe jeton. Banesa përfshinë vendin në të cilin zhvillohet jeta private e një personi

(ai vend, ta zëmë, mund të jetë edhe një shtëpi lëvizëse kampingu). Pacenueshmëria mund të përfshijë edhe objektet afariste, si dhe posedimet e gjëra që rrethojnë vetë banesën, pasuria në të cilin ndodhet shtëpia. Për këtë arsye kuptimi i banesës përcaktohet në secilin rast konkret me rastin e mbrojtjes së kësaj të drejte. Bartës i kësaj të drejte është pronari i banesës apo anëtari i familjes që banon (jeton) në të, si dhe poseduesi i saj, ta zëmë, qiramarrësi i banesës.

Pacenueshmëria e banesës konsiston në atë se, askush pa lejen e pronarit ose poseduesit të banesës (shtëpisë, pasurisë) nuk ka të drejtë të futet në banesë, përfshirë organet e shtetit, përfshirë personat e tjerë fizikë dhe juridikë. Jeta në bashkësi, megjithatë, krijon nevojën për shkelje të parimit të pacenueshmërisë së banesës, përkatësisht të hyhet në banesë edhe pa lejen dhe vullnetin e pronarit ose poseduesit të saj, pa urdhër gjyqësor e pa dëshmitar. Arsyet për një gjë të tillë zakonisht përcaktohen në kushtetuta dhe kanë të bëjnë me pengimin e kryerjes së veprës penale, largimin e rrezikut ndaj njerëzve dhe pasurisë për shkak të zjarrit, vërshimeve, eksplodimeve dhe fatkeqësive të tjera. Në banesën e tjetrit mund të hyhet pa lejen e pronarit apo poseduesit kur për këtë ekziston një urdhër për bastisje, me qëllim të zhvillimit të papenguar të procedurës gjyqësore ose ekzekutimit të vendimit gjyqësor. Organet që lëshojnë këtë leje apo urdhër zakonisht janë gjykatat apo organet e ndjekjes penale (prokuroria), e përjashtimisht mund të jenë edhe organet e pushtetit ekzekutiv.[29]

Procedura e hyrjes në banesën e huaj rregullohet me ligj. Personat e autorizuar duhet të kenë autorizim përkatës dhe, sipas rregullit, bastisja e banesës bëhet në praninë e dëshmitarit. Pacenueshmëria e banesës mbrohet jo vetëm me kushtetutë por edhe me legjislacion penal. Cenimi joligjor dhe pa autorizim i banesës dhe posedimeve, konsiderohet, në shumicën e vendeve, vepër penale.

Fshehtësia e korrespondencës është një e drejtë me të cilën mbrohet komunikimi privat i personave fizik dhe juridik. Njeriu është qenie shoqërore dhe komunikon në mënyra të ndryshme. Me kënd komunikon, kur, sa dhe lidhur me çka, paraqet privatësi të personalitetit dhe është objekt i mbrojtjes. E drejta për fshehtësinë e korrespondencës me kohë ka ndryshuar përmbajtjen, duke ndjekur zhvillimin teknologjik në komunikim, për të evoluar nga karrocat postare në postën elektronike dhe telefoninë mobile. Të drejtën në fshehtësinë e korrespondencës e kanë edhe personat juridik, përkatësisht lidhur me komunikimet e tyre afariste.

Fshehtësia e komunikimit, në të vërtetë është mbrojtja e komunikimit nga publiku. Ajo përfshinë korrespondencën në kuptim të ngushtë – komunikimet përmes postës, telegrafit, telefonit, postës elektronike dhe komunikimet tjera të kësaj natyre. Të dhënat mbi korrespondencën, siç është lista e thirrjeve apo, në kohët e sotme, lista email-ave dhe postimeve të tjera elektronike, gjithashtu janë objekt mbrojtje. Kjo e drejtë iu kufizohet personave që komunikojnë në kushte specifike të paraburgimit, vuajtjes së dënimit me burg, burgimit shtëpiak, personave në shërbim ushtarak (për lloje të caktuar të korrespondencës), ish të burgosurve ndaj të cilëve ushtrohet masa e mbikëqyrjes së posaçme. Këtyre personave, në anën tjetër, iu lejohet komunikimi papengesë me mbrojtësit e tyre, që është pasojë e garancionit kushtetues, i mishëruar në të drejtën për mbrojtje në procedura gjyqësore. Te kufizimi i fshehtësisë së korrespondencës, me rëndësi është që ai duhet të jetë i natyrës së përkohshme.

Deri te shmangia prej fshehtësisë së korrespondencës mund vije vetëm në bazë të arsyeve të dhëna në kushtetutë dhe sipas procedurës së përcaktuar me ligj. Arsyet e përcjelljes së komunikimeve të të tjerëve kanë të bëjnë me pengimin e kriminalitetit dhe çrregullimeve, ecurinë e procedurës hetimore dhe gjyqësore, sigurinë dhe mbrojtjen e shtetit, përkatësisht me aktivitet kundërinformativ. Vendimet

[29] Office of the Privacy Commissioner of Canada (ed.), *Surveillance, Search or Seizure Powers Extended by Recent Legislation in Canada, Britain, France and the United States* (diskuton masat e përgjimit, bastisjes dhe konfiskimit në kontekst të luftës kundër terrorizmit dhe në dritën e rregullativës më të re në këto vende, të nxjerrur në vijim të luftës kundër terrorizmit ndërkombëtar që ka marrë hov pas ngjarjeve tragjike terroriste të 11 shtatorit 2001 në SHBA). Në internet: https://www.priv.gc.ca › parl_bg_090507_e (shikuar në prill 2022).

për shmangie nga fshehtësia e korrespondencës, vëllimi dhe kohëzgjatja e saj, sipas rregullit i cakton gjykata, bazuar në procedurën e përcaktuar ligjore.

Përveç këtyre dy të drejtave tradicionale, përbërës të së drejtës për privatësi, privatësia e personit mbrohet edhe me të drejta të posaçme që mbrojnë jetën private, në veçanti familjen dhe të dhënat e informatat mbi vetë personalitetin. Mbrojtja e jetës private nënkupton që çdo kush ka të drejtë që veprimet dhe marrëdhëniet private, me fillim nga ato më të zakonshme, të karakterit të përditshëm (ushqimi, daljet, shëtitjet, puna, shitblerjet etj.) e deri te orientimi seksual, t'i ruaj nga publiku dhe dijenia e personave të tretë. Mbrojtja e jetës private vepron ndaj personave fizikë dhe juridikë (ta zëmë, medies), ndaj personave privatë dhe institucioneve me autorizime publike. Brenda kësaj të drejte, një mbrojtje të veçantë gëzojnë **të dhënat personale**, të cilat, me qëllim të realizimit të një qëllimi, u janë dorëzuar (dhënë) personit të tretë ose janë marrë me rrugë gjyqësore. Këto të dhëna mund të përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë dorëzuar apo marrë. Kështu, ta zëmë, banka mund të përdorë të dhënat personale dhe financiare, të cilat i ka deponuar kërkuesi i kredisë te ajo, por vetëm për qëllim të miratimit të kredisë së personit të tillë. Gjykata mund të kërkoj të dhënat për vendbanimin e një personi, me qëllim që të njëjtit t'i dërgohet ftesa gjyqësore.

Nga personat e tretë dhe publiku në veçanti mbrohet jeta familjare dhe marrëdhëniet në familje. Familja është qelizë themelore e shoqërisë, e mbrojtur me kushtetutë dhe legjislacion penal. Kjo mbrojtje përfshinë ndalimin e bërjes publike të informatave mbi jetën familjare dhe marrëdhëniet në mes të anëtarëve të familjes. Mbrojtja e jetës familjare nënkupton edhe të drejtën për të vendosur lirshëm për lindjen e fëmijëve (ka pasur shtete, si **Kina** dikur, që kanë ndaluar lindjen e më shumë se dy fëmijëve).

Mbrohen anëtarët e familjes si bashkëshort dhe të afërm të gjakut (prindërit, fëmijët, nipërit e mbesat), por edhe anëtarët familjeve jashtëmartesore dhe të adoptuar. Familjen që e formojnë bashkëshortët e gjinisë së njëjtë paraqet formë të re të jetës familjare, në themel të së cilës është partneriteti i regjistruar apo martesa, që lejohen në disa shtete. Këto dy forma të familjes, që në aspektin kushtetues akoma nuk kanë marrë karakterin universal të garancioneve kushtetuese, prodhojnë pasoja të ndryshme sa i përket të drejtës së trashëgimit dhe adoptimit të fëmijëve: ta zëmë, adoptimi lejohet në martesë, kurse në partneritetin e regjistruar nuk lejohet.

Në aktet ndërkombëtare garantohet e drejta në lidhjen e martesës. **DUDNJ** (neni 16), **PDCP** (23) dhe KEDNJ (neni 12) garantojnë të drejtën për themelim të familjes dhe lidhjes së martesës, që është baza e familjes tradicionale. E drejta në familje, në "formën natyrore, themelore dhe përbërëse të shoqërisë", garantohet për personat madhorë, meshkuj dhe femra, përmes lidhjes së martesës me shprehje reciproke dhe të lirshëm të vullnetit, pa kufizime në bazë të racës, fesë apo shtetësisë së bashkëshortëve.

Mbrojtja e jetës familjare ekziston edhe pas ndërprerjes së martesës, sepse të dhënat mbi familjen mbrohen edhe pasi martesa të ketë marrë fund. Mbrojtja e jetës familjare përplotësohet me të drejta të posaçme dhe status kushtetues që gëzojnë nëna, fëmija dhe prindi i divorcuar.

6.1.7. Të drejtat personale që formojnë të drejtën për gjykim të drejtë

Në këtë grupim të veçantë të lirive dhe të drejtave të njeriut futen liritë dhe të drejtat që mbrojnë pozitën e individin në procedura gjyqësore. Nisur nga ajo se gjykata është organ shtetëror që ka të drejtë të kufizojë dhe të marr liritë dhe të drejtat më të rëndësishme, siç janë liria personale, liria e lëvizjes dhe deri te e drejta për jetë, atëherë duhet të ekzistojnë garancione juridike që organi i tillë i pushtetit me autorizime do të jetë tërësisht i pavarur, i paanshëm, i drejtë dhe efikas. Këtu në të vërtetë bëhet fjalë për rregulla sipas të cilave gjykata duhet të veprojë, në mënyrë që çdo kush të ketë gjykim të ndershëm. Këto rregulla, për nga natyra e tyre janë rregulla penale të karakterit materialo-juridik dhe procedural-juridik, të cilat, për shkak të rëndësisë dhe pasojave që prodhojnë ndaj të drejtave dhe lirive të tjera,

përcaktohen me kushtetuta dhe akte më të rëndësishme juridiko-ndërkombëtare. Në fakt, këto garancione kanë origjinë ndërkombëtare dhe janë konstitucionalizuar me kushtetutat e vendeve sovrane dhe të pavarura sipas **procedurave standarde** për **internalizimin e normave ndërkombëtare** në rendin e brendshëm juridik.[30]

Në **DUDNJ** secilit individ i garantohet e drejta për gjykim të drejtë, të hapur dhe e drejta për mbrojtje. Gjykata që vendos për të drejtat dhe detyrimet duhet të jetë e pavarur dhe e paanëshme. Deklarata përmban **prezumimin e pafajësisë** (individi konsiderohet i pafajshëm deri në konstatimin e fajësisë së tij/saj me vendim të formës së prerë) dhe parimin e ligjshmërisë së veprës dhe sanksionit penal (mund të gjykohet vetëm për vepra që kanë qenë penale në kohën e kryerjes dhe nuk mund të shqiptohet sanksioni më i rëndë se ai i përcaktuar në momentin e kryerjes së veprës penale) (nenet 11 dhe 17).

Të drejtën për gjykim të drejtë edhe më në detaje e normon **PDCP**-ja. Nisur nga ajo se para gjykatave të gjithë janë të barabartë, ky akt përcakton arsyet për përjashtim të publikut (interesi i moralit, rendi dhe siguria publike, interesi i drejtësisë, i palëve ose i të miturve, kontestet martesore dhe kontestet rreth kujdestarisë ndaj fëmijëve), të drejtën e të pandehurit për informim në një afat sa më të shpejt mbi fajin në gjuhën që e kupton, të drejtën për kohën e duhur për të përgatitur mbrojtjen, e drejta për gjykim në kohë të arsyeshme (pa vonesë të madhe), të drejtën për të qenë i pranishëm në gjykim, për mbrojtje vetjake ose përmes mbrojtësit, të drejtën për mbrojtje sipas detyrës zyrtare, të drejtën e të qenit aktiv në procedurë (e drejta për propozim dhe dëgjim të dëshmitarëve, për propozim të provave dhe të drejtat e ngjashme), e drejta për gëzim dhe shfrytëzim efektiv të të drejtave të njëjta me përfaqësuesin e akuzës, të drejtën për interpret gjuhësor, e drejta për mosdëshmim kundër vetvetes dhe mospranim të fajësisë, e drejta për ankesë, e drejta për kompensim të dëmit për anulim të aktgjykimit të mëparshëm, mbrojtja nga gjykimi i serishëm për të njëjtën çështje. Në veçanti kihet parasysh për interesin e personit të mitur që gjykohet (neni 14).

KEDNJ-ja garanton të drejtën për gjykim të drejtë (neni 6), në një mënyrë mjaft të ngjashme me PDCP-në. Përbërësit e kësaj të drejte, që normohen me këtë akt të rëndësishëm juridik evropian, janë: e drejta për shqyrtim të drejtë dhe publik, gjykimi në një afat të arsyeshëm para gjykatës së pavarur dhe të paanshme, të themeluar sipas ligjit dhe garancionet tjera. Në veçanti garantohet legaliteti i veprës dhe sanksionit (neni 7) dhe e drejta për mjet efektiv juridik para autoriteteve vendore (jo vetëm pranë gjykatave) (neni 13). Nga të drejtat që përbëjnë të drejtën për gjykim të drejtë nuk mund të hiqet dorë as në kohën e gjendjes së jashtëzakonshme, që do të thotë se këto janë të drejta të mbrojtura në mënyrë absolute – **të drejta absolute njerëzore** (neni 15).

Në vijim do të veçojmë disa të drejta që përbëjnë të drejtën për gjykim të drejtë. **E drejta për gjykatë të pavarur, të paanshme dhe ligjore ka disa elemente**. Një gjykatë konsiderohet e pavarur atëherë kur ekzistojnë garancione kushtetuese sa i përket zgjedhjes objektive të gjyqtarëve dhe kushtet për punë të pavarur të tyre.[31] Kjo nënkupton se gjyqtarët duhet të zgjidhen sipas kritereve paraprakisht të përcaktuara dhe të ditura, mbi bazën e të cilave bëhet vlerësimi objektiv i kandidatëve për gjyqtarë dhe atë nga ana e një trupi që ndodhet jashtë ndikimit politik (ta zëmë, **këshillat gjyqësore** apo trupat ekuivalente me to, si sistem mjaft i përhapur vetërregullativ i gjyqësorit dhe punës së tij, me qëllim të sigurimit dhe garantimit të pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit, bazuar në rregullat e etikës profesionale që implementohen nga komuniteti i juristëve; këshillat gjyqësore apo trupat e ngjashëm kanë pasur një

[30] Cf. më shumë për këtë në Enver Hasani, "Veçoritë themelore të sistemit kushtetues në Kosovë". E *DREJTA/LAW* Vol. XL No.1-4 (2014) fq. 17-45 në fq. 11-20; Enver Hasani, "Basic Features of the Constitutional System in Kosovo". Në Rainer Arnold, Jose Ignacio Martinez-Estay (eds.), *Rule of Law, Human Rights and Judicial Control of Power. Some Reflections from National and International Law* (SPRINGER International Publishing AG: Switzerland, 2017) fq. 149-176 në fq. 152-158.

[31] Cf. më shumë për këtë në Daniel Smilov, "The Judiciary: The Least Dangerous Branch? Në Fq. 859-873. Në Michel Rosenfeld and Andras Sajo(eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law*, fq. 859-873.

përqafim të madh në Evropën ish-komuniste, pas mbarimit të Luftës së Ftohtë).[32] Gjatë gjykimit, duhet të mënjanohet çdo ndikim dhe presion i jashtëm në gjykatën, qoftë politik, medial apo i bazuar në grupe të interesit. Paanëshmëria e gjykatës ka të bëjë me secilin rast konkret, në të cilin gjyqtari apo trupa gjyqësore është tërësisht e painteresuar (nuk ka konflikt interesi) për fundin e rastit. Në situatën e kundërt krijohen arsyet për përjashtim të gjyqtarëve. Gjykatë e ligjshme është ajo që është formuar me ligj, si e tillë e përhershme dhe kompetente. Kjo nënkupton se nuk mund të ekzistojnë gjykata të jashtëzakonshme **ad hoc** dhe as nuk mund të gjykojë gjykata që nuk ka kompetencë kohore, lëndore dhe territoriale. Sipas autorizimit shprehimor kushtetues, me ligj mund të themelohen **gjykata të specializuara** për adresimin e **çështjeve dhe problemeve të specializuara**. Ky standard ka relevancë në veçanti në shoqëritë në tranzicion nga diktaturat, konfliktet e armatosura dhe mosmarrëveshjet e dhunshme në gjendje paqeje dhe sigurie.

Të drejtat e të pandehurit në procedurë penale bazohen në dy parime të vjetra. I pari është parimi i **prezumimit të pafajësisë**, që nënkupton se përfaqësuesi i akuzës duhet ta provoj fajësinë e të pandehurit. Mbi akuzuesin bie barra e të provuarit, sepse deri në formën e prerë të aktgjykimit i pandehuri konsiderohet i pafajshëm (edhe atëherë kur faji është i dukshëm **prima facie**: ta zëmë, vrasja në praninë e disa dëshmitarëve). Ky prezumim detyron krejt organet e pushtetit, por edhe të tjerët, opinionin publik, që mos të cenojnë të drejtat e dikujt duke e shpallur fajtor paraprakisht. Pikërisht në këtë prezumim mbështetet rregulli tjetër penal, sipas së cilit, në rast dyshimi duhet vepruar në favor të pandehurit (in dubio pro reo). I dyti është **parimi i legalitetit të veprës dhe sanksionit**, i cili gjithashtu përbën një supozim që mbron të drejtat e të pandehurit dhe ofron siguri juridike në procedurë penale. Askush nuk mund të ngarkohet për një vepër që nuk ka qenë vepër penale në kohën e kryerjes, e as të shqiptohet sanksioni që nuk ka qenë i përcaktuar në kohën e kryerjes së veprës (**nullum crimen sine lege, nulla poena sine lege**). Lidhur me sanksionin ekziston një përjashtim sa i përket veprimit retroaktiv të ligjit: sanksioni që nuk ka qenë i përcaktuar në kohën e kryerjes së veprës mund të shqiptohet nëse është më i favorshëm për kryerësin e veprës.

E drejta për qasje të barabartë në gjykatë përfaqëson konkretizim të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut. Kjo sepse një e drejtë e tillë nënkupton që ekziston një organ ku qytetarët mund të drejtohen për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të tyre. Qasja e barabartë nënkupton që palët duhet të kenë pozitë juridikisht të barabartë gjatë gjykimit ("barazia e armëve"). Kjo e drejtë shërben për të penguar diskriminimin, sepse nuk mund të ekzistojnë gjykata për kategori të posaçme të njerëzve, siç kanë qenë dikur gjykatat aristokratike dhe gjykatat ushtarake. U mor vesh, mund të ekzistojnë juridiksione të posaçme për persona të posaçëm, zakonisht për funksionarët e lartë shtetërorë, por këtu nuk bëhet fjalë për gjykata të themeluara si gjykata permanente për persona të posaçëm. Përveç kësaj, edhe personat që nuk kanë aftësi veprimi nuk mund të gëzojnë këtë të drejtë, përfshirë këtu një kategori të posaçme të njerëzve që vështirësojnë punën e gjykatës (të a.q".ndërgjyqësit e sëmurë").

Gjykim të drejtë nuk ka pa **publicitetin e gjykimit.** Parimi i publicitetit përfshinë shqyrtimin e çështjes dhe ekzekutimin e vendimit përfundimtar. Ky parim pengon që gjykatat të tjetërsohen dhe të ndajnë ndonjë "drejtësi esnafësh", për shkak se në vazhdimësi janë nën mbikëqyrjen e publikut. Publiciteti ndikon si në cilësinë e gjykimit ashtu edhe në forcimin e besimit në gjykata. Për shkak të nevojës për mbrojtje të interesit publik por edhe shkaku i interesit të vetë palëve në procedurë, publiku nga disa gjykime mund të përjashtohet. Arsyet për përjashtim të publikut përcaktohen me ligj.

Mbrojtja e lirive dhe të drejtave para gjykatave ka kuptim vetëm nëse realizohet (kryhet) me kohë, në kohën kur mbrojtja është akoma e nevojshme. Gjykim i drejtë, pra, nënkupton **gjykim në afat të arsyeshëm.** Ky afat nuk është i dhënë paraprakisht, por vlerësohet në secilin rast konkret. Afati arsyeshëm

[32] Daniel Smilov, "The Judiciary: The Least Dangerous Branch?", në Fq. 859-873. Në Michel Rosenfeld and Andras Sajo(eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law*, fq. 86.

varet nga ndërlikueshmëria e lëndës (ta zëmë, numri i të pandehurve), nga sjelljet procedurale të palëve në procedurë (ta zëmë, zvarritja, shmangia e gjykatës etj.), por edhe nga urgjenca e qëllimit konkret që synohet të arrihet me procedurë gjyqësore (ta zëmë, kompensimi i dëmit personit të sëmurë). Konform rrethanave që shoqërojnë procedurën, do të bëhet edhe vlerësimi nëse ka ardhur deri te cenimi i të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm.

Gjatë gjykimit, i pandehuri ka një sërë të drejtash të posaçme, që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e gjuhës së vetë, përkthimin pa pagesë, kohën e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes, të drejtën për t'u mbrojtur vetë ose me ndihmën e mbrojtësit, të drejtën për të qenë aktiv në procedurë: të pyes dëshmitarët, propozoj prova, të syzohet me të akuzuarin, e drejta për ankesë dhe mjet tjetër efektiv të rregullt dhe të jashtëzakonshëm, të drejtën për kompensim të dëmit për shkak të paraburgimit pa të drejtë gjatë procedurës dhe për shkak të anulimit të aktgjykimit dënues të mëhershëm, e drejta për shlyerje nga evidenca e të dënuarve.

6.2 Liritë dhe të drejtat politike

Liritë dhe të drejtat politike mundësojnë ushtrimin e pushtetit ose ndikimin në pushtet. Përmes tyre, individi ose kolektiviteti marrin pjesë në jetën publike të shtetit, pjesëmarrje që shihet, pikë së pari, në procedurën e formimit të organeve të pushtetit, përkatësisht në procesin e zgjedhjeve.

Në liri dhe të drejta politike llogariten: **e drejta zgjedhore**, **liria e shtypit** (medies), **liria e bashkimit dhe tubimit politik** dhe **e drejta e pjesëmarrjes në punën e organeve të pushtetit**. Liritë dhe të drejtat politike janë të pashmangshme në shoqëritë bashkëkohore. Në shumicën e vendeve ekziston, së paku formalisht, një regjim demokratik që nënkupton, mes tjerash, mbajtjen e zgjedhjeve të lira periodike dhe një sistem shumëpartiak. Kjo bën që liritë dhe të drejtat politike të shihen, në të vërtetë, si të **drejta për demokraci**. Duke shfrytëzuar këto liri e të drejta, individi nuk bëhet organ shtetëror, funksionar, por fiton cilësinë e qytetarit në kuptimin politik të fjalës, shndërrohet në person politikisht aktiv. Këto janë të drejta njerëzore të pjesëmarrjes, të drejta të statusit aktiv, që kanë të bëjnë me marrëdhënien e qytetarit me pushtetin publik, përkatësisht me shtetin.

Ajo që logjikisht i paraprinë lirive dhe të drejtave politike është liria e shprehjes së mendimit, qëndrimeve, kritikës dhe informacionit. Për këtë arsye **liria e shprehjes është liri politike në rastet kur me te synohet arritja e një qëllimi politik.** Më herët u tha se qëndrimet mund të shprehen në mënyra të ndryshme: me gojë dhe me shkrim, por edhe në vepra artistike dhe muzikore, fotografi dhe në mënyra të tjera. Liria e shprehjes politike mund të kufizohet për arsye të thëna në ligj, ekzistenca e të cilave vlerësohet për çdo rast konkret. Një formë e përgjithshme e kufizimit të shprehjes është **fjalimi urrejtjes**, kur është politikisht i motivuar. Edhe këtu, megjithatë, nuk ekziston një dallim i qartë se deri kur konsiderohet një shprehje si fjalim politik dhe kur ajo kthehet në **fjalim të urrejtjes**. E tillë do të ishte, ta zëmë, thirrja për luftë agresive, që përfaqëson një mjet për arritjen e qëllimeve politike. E kundërta e kësaj, thirrja për mbrojtje të vendit nuk do të konsiderohej si fjalim i urrejtjes. **PDCP**-ja parashikon ndalimin e çdo propagandimi të luftës, si dhe çdo thirrje për urrejtje nacionale, racore apo fetare, e cila paraqet ftesë për diskriminim, armiqësi dhe dhunë (neni 20).

6.2.1. E drejta zgjedhore

E drejta zgjedhore është e drejtë themelore politike. Një status të tillë e ka sipas akteve ndërkombëtare dhe në kushtetutat nacionale, sepse zgjedhjet janë bazë e legjitimitetit të pushtetit. E drejta zgjedhore definohet si e drejtë e qytetarit për të zgjedhur organet e pushtetit (**e drejta zgjedhore aktive**, zotësia zgjedhore) dhe e drejta për të qenë i zgjedhur në ato organe (**e drejta zgjedhore pasive**, zotësia për përfaqësim). Në mes të këtyre dy të drejtave në kuadër të së drejtës komplekse zgjedhore ekzistojnë shpërputhje të mëdha sa i përket shfrytëzimit: vetëm një numër më i vogël i qytetarëve e shfrytëzon

të drejtën pasive zgjedhore, në ndërkohë që numri i atyre që votojnë është më i madh pakrahasimisht, nganjëherë edhe përtej 50% e qytetarëve me të drejtë vote. Përveç asaj që jep mundësi për votim dhe kandidim në zgjedhje, e drejta zgjedhore përfshinë edhe të drejtën për të votuar në **referendum**. Në kuptim më të gjerë të fjalës, **e drejta zgjedhore** përbëhet nga disa të drejta dhe veprime të natyrës materiale dhe procedurale gjatë kohës së zgjedhjeve dhe në meskohën e tyre, gjatë kandidimit, fushatës zgjedhore, regjistrimit në listat zgjedhore, votimit.

E drejta zgjedhore, në parim, nuk paraqet në të njëjtën kohë edhe detyrim për qytetarin, i cili jo medoemos duhet ta shfrytëzoj këtë të drejtë. Në disa vende, megjithatë, e drejta zgjedhore në të njëjtën kohë përfaqëson detyrimin për dalje në zgjedhje, mospërmbushja e të cilit tërheq me vete dënimin, zakonisht me të holla (ta zëmë, **Australia**).

Nga nxjerrja e kushtetutave të para, e drejta zgjedhore ka evoluar shumë në drejtim të zgjerimit të rrethit të njerëzve me të drejtë aktive dhe pasive zgjedhore. Në fillim kanë ekzistuar kufizime të mëdha, të bazuara në pasuri, shkallën e arsimimit, racën, fenë. E drejtë universale u bë vetëm në gjysmën e dytë të shekullit XX (një njeri, një votë). Kufizimi që ka zgjatur më së gjati ka pasur të bëjë me të drejtën zgjedhore të grave, të cilat, në disa vende të Lindjes së Mesme, këtë të drejtë e fitojnë në fillim të shekullit XXI. Edhe në vendet ku gratë kanë fituar të drejtën zgjedhore, megjithatë, akoma ekziston nënpërfaqësimi i tyre, dukshëm më i madh në krahasim me burrat.

Kërkesa që e drejta zgjedhore të jetë e drejtë e përgjithshme rrjedh nga vetë sovraniteti popullor, si themel i pushtetit shtetëror. Sovraniteti popullor është shprehje e vullnetit të popullit, kurse populli, në kuptimin politik, përfshinë krejt qytetarët. Për arritjen dhe realizimin e të drejtës zgjedhore, megjithatë, kërkohet plotësimi i disa **kushteve faktike dhe juridike**. Për të **drejtën aktive zgjedhore** duhet domosdo arritja e një moshe të caktuar (së paku moshën madhore), që qytetari të ketë shtetësi, të ketë zotësi veprimi (të jetë i llogaritshëm), të ketë vendbanimin dhe vendqëndrimin në shtetin dhe njësinë zgjedhore. Thuajse kushte të njëjta kërkohen edhe për realizimin e të **drejtës pasive zgjedhore**, mirëpo këtu vjen deri te ashpërsimi i disa prej tyre: mosha duhet të jetë më shumë se madhore, ta zëmë, 25, 30, 35 etj); shtetësia duhet të ekzistojë që nga lindja, vendbanimi dhe vendqëndrimi duhet të kenë qenë të vlefshëm për një kohë të caktuar pandërprerë etj. Për realizimin e të drejtës zgjedhore, përkatësisht për votim dhe kandidim, qytetari domosdo duhet që të jetë i regjistruar në dokumentin publik mbi zgjedhësit, në listën zgjedhore.

E drejta zgjedhore mund të **pushoj,** përgjithmonë ose përkohësisht. Humbja e ndonjërit prej kushteve të nevojshme, siç janë shtetësia, zotësia për të vepruar, vendbanimi, në të njëjtën kohë përfaqëson humbje të së drejtës zgjedhore të individit. Deri në momentin kur këto kushte të plotësohen, vazhdon humbja e kësaj të drejte. Humbja mund të jetë edhe rezultat i një vendimi juridik, siç janë aktgjykimi i gjykatës me të cilin merren apo suspendohen të drejtat politike, vendimi që për arsye politike disa persona i zhvesh nga e drejta zgjedhore (ta zëmë, anëtarët meshkuj të dinastisë së përmbysur Savoja në Itali, deri në vitin 2002; Mbretit Zog deri pas vitit 1997; sulltanëve otomanë deri në ditët e sotme etj.).

DUDNJ-ja njeh të drejtën e çdo kujt për të marrë pjesë në udhëheqjen me vendin e vet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes përfaqësuesve të zgjedhur lirshëm. Ushtrimi i drejtpërdrejtë i pushtetit është vendosja me referendum apo **referendumi**, kurse ushtrimi përmes përfaqësuesve të zgjedhur lirshëm janë **zgjedhjet** apo vendosja me zgjedhje. Vullneti politik i popullit është themel i pushtetit shtetëror dhe manifestohet në zgjedhje periodike dhe të lira, me votim të fshehtë. Në zgjedhje marrin pjesë qytetarët që kanë të drejtë të përgjithshme dhe të barabartë të votës (neni 21). **PDCP-ja** ka përpunuar më tutje dispozitat e **DUDNJ-së**, duke garantuar të drejtën zgjedhore pa asnjë diskriminim dhe kufizim të panevojshëm. Me këtë është krijuar hapësira që e drejta zgjedhore të kufizohet për individin, nëse nuk plotëson kushtet e njëjta të përcaktuara për të gjithë qytetarët. Kështu, ta zëmë, nëse ndaj individit është shqiptuar masa e marrjes së zotësisë së veprimit sipas një procedure të përcaktuar ligjore, i merret edhe

e drejta zgjedhore. Protokolli 1 (1952) i KEDNJ-së ka themeluar të drejtën për zgjedhje të lira, duke krijuar në mënyrë të tërthortë të drejtën zgjedhore, me dispozitën që garanton shprehjen e lirë të mendimit të popullit në zgjedhje të lira periodike dhe të fshehta (neni 3).

E drejta zgjedhore është **e drejtë kushtetuese** në shumicën e shteteve, sepse garantohet me aktin më të lartë të vendit, kurse më afër rregullohet me ligj. Me kushtetutë zakonisht caktohen karakteristikat e të drejtës zgjedhore, duke theksuar se e drejta e votës është e drejtë e përgjithshme, e barabartë, e fshehtë dhe e drejtpërdrejtë. Me kushtetutë mund të përcaktohen kushtet për të drejtën zgjedhore aktive dhe pasive, siç janë: zotësia e veprimit, shtetësia, vendbanimi, e drejta zgjedhore e të huajve dhe mundësia e kufizimit së të drejtës zgjedhore, kurse përjashtimet nga kushtet e përgjithshme së të drejtës zgjedhore zakonisht i përcakton ligji. Me kushtetutë gjithashtu rregullohen situatat e konfliktit të interesit parlamentar, siç është pamundësia e ushtrimit të njëkohshëm të disa funksioneve publike, që mund të jetë kufizim i të drejtës zgjedhore pasive, përkatësisht të drejtës për kandidim (i a.q. **joeligjibiliteti parlamentar**)

Nga e drejta e përgjithshme dhe e barabartë e votës rrjedhë e drejta për qasje të barabartë ndaj shërbimeve publike. Nëse bartësit e funksioneve publike zgjidhen në mënyrë të drejtpërdrejt, ta zëmë, deputetët apo kryetari i komunës/bashkisë, atëherë e drejta në qasje në shërbime të tilla praktikisht është e drejta për kandidim për funksionet në fjalë. Kur kemi të bëjmë me qasjen në shërbime të tjera publike, ta zëmë në organe të administratës, atëherë kjo e drejtë është politike në kuptim të asaj që çdo kush ka të drejtë të udhëheq (drejtoj me) punët publike të vendit të vet.

6.2.2. Liria e shtypit

Ka një kohë të gjatë që, në kuptimin e ngushtë, shtypi i lirë (gazetat) përbën kushtin thelbësor pa të cilin as që mund të mendohet shteti demokratik. Liria e shtypit është e drejtë politike. Kjo sepse shtypi ka qenë dhe mbetet mjet i opozitës për të kritikuar pushtetin me qëllim të ndikimit në opinionin politik dhe krijimit të kushteve për fitore në zgjedhje. Me shtypin e lirë, pushteti është i kufizuar. Pa një shtyp të lirë, pushteti do të ishte i papenguar, për shkak se opozita nuk do të kishte pasur një mjet të vlefshëm politik për sfidim paqësor dhe me sukses të pushtetit, me qëllim të ndërrimit të tij. Për këtë arsye, shtypit të lirë me të drejtë i vishet cilësia e faktorit të domosdoshëm për një shtet demokratik, përkatësisht cilësia e "gardianit të demokracisë". Shtypi i lirë është i domosdoshëm për ekzistencën e konstitucionalizmit siç e njohim sot. Një thënie franceze thotë: "Më merrni krejt liritë, ma leni vetëm lirinë e shtypit dhe do të shini që do t'i rikthej të gjitha liritë e marra". Ose një tjetër, jo thënie popullore, por e shqiptuar nga goja e **Mirabosë** (Honore G. R. Mirabeu: 1749-1791), i cili pat thënë: "Hiqjani Anglisë lirinë e shtypit dhe jepjani atë Turqisë, dhe do të shihni se si kjo e fundit do të bëhet si Anglia, e cila, në anën tjetër, do të shndërrohet njëkohësisht në Turqi". Për shkak të rëndësisë së madhe që ka, liria e shtypit sot e kësaj dite karakterizohet si "fuqia e shtatë" (krahas gjashtë fuqive të mëdha të kohës së Kongresit të Vjenës: Anglia, Austria, Franca, Prusia/Gjermani, Piemonti/Italia dhe Rusia) dhe "pushteti i katërt" (krahas pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor).[33] Për shkak të kësaj peshe që ka shtypi, shpesh shtrohet pyetja kardinale: nëse mediet janë mbrojtës të demokracisë, atëherë kush i ruan rojtarët e demokracisë? Përgjigja do të ishte – qytetarët përmes normimit apo rregullativës juridike adekuate dhe përmes gjyqeve si institucione që duhet të vendosin shpejt dhe të ofrojnë mbrojtje efikase në rastet konkrete të cenimit të lirive dhe të drejtave të personave fizik dhe juridik, në procedurë penale dhe kundërvajtëse, por edhe në procedura civile për kompensim të dëmit të shkaktuar.

Liria e shtypit është emërtimi tradicional i kësaj të drejte, që ka lindur si rezultat i rëndësisë kolosale politike të gazetës (shtypit). Burim informacioni sot janë edhe mediet tjera, që në masë të konsiderueshme e kanë shtypur rëndësinë që kanë pasur gazetat e shkruara (shtypura), të cilat ekzistojnë edhe sot

[33] Slobodan P. Orlović: *Ustavno parvo* (Pravni fakultet Univerziteta u Novom Sadu: Novi Sad, 2019) fq. 102.

por në një masë e me ndikim shumë më të vogël se në të kaluarën. Nisur nga ajo se ekzistojnë mundësi të informimit masiv dhe publik, përmes televizionit, radios dhe internetit, më me vend për këtë liri do të ishte emërtimi si **liria e medies**.

Liria e shtypit është e drejtë njerëzore, sepse i mundëson individit apo grupimit të organizuar të shprehin mendimet e tyre. Ajo që mbron kjo liri është mendimi politik, sipas rregullit mendimi që kritikon pushtetin. Për këtë arsye, liria e shtypit fillimisht ka përfshirë dhe nënkuptuar vetëm lirinë nga shteti dhe ndikimi i tij kufizues, ndikim i njohur si **censurë**. Sot, në kohën e globalizmit, përhapja e informatave përmes medies përfaqëson një punë të dinjitetshme, me të cilën ndikohet në mendimin e përgjithshëm publik jo vetëm në shtet, por edhe në nivel global. Kapitali gjithnjë e më i madh që rri parapa medies, private ose shtetërore, gjen interesin e vet në mbrojtjen interesit vetjak, gjë që rrezikon lirinë dhe pavarësinë e shtypit. Qëndrimet e shprehura në mediet e tilla nuk janë kritikë dhe mendim i lirë, në situata mjaftë të shpeshta, por të drejtuara kah mbështetja e pushtetit aktual, organizata politike ose grupi përkatës i interesit.

Liria e shtypit garantohet me **kushtetutë** dhe mund të kufizohet juridikisht. Garancioni konsiston në të drejtën e çdo kujt për të themeluar medie dhe shprehur mendimet përmes medies. Kjo liri gjen konfirmimin e realizimit të vet në dispozitat kushtetuese dhe dispozitat tjera që ndalojnë **censurën**, e cila mund të jetë dy llojesh: **preventive**, kur ndalohet shprehja e mendimit dhe dalja e shtypit; dhe **ndëshkuese**, kur lajmi pas dhënies nuk emitohet (jepet) për publikun, ose kur është dhënë – tërhiqet nga qarkullimi tirazhi (vëllimi), përkatësisht burimi ku është shprehur informacioni. Kufizimet e lirisë së shtypit mund të përcaktohen në kushtetutë ose përmes ligjeve. Ato vihen, në rend të parë, për shkak se me liri të pakufizuar të shtypit mund të shkelen të drejtat e liritë e të tjerëve dhe mund të rrezikohet interesi i përgjithshëm. Shtypi është një mjet shumë i përshtatshëm për keqpërdorim nëse me të përhapen informacione të pavërteta dhe shkelet dinjiteti, autoriteti dhe nderi dhe, në përgjithësi, të drejtat e personit tjetër. Interesi i përgjithshëm dikton kufizimin e kësaj të drejte, kur me të rrezikohet: siguria shtetërore me thirrje për kryengritje të armatosur, rendi dhe qetësia publike, morali ose siguria e individit, kur kjo ka të bëjë, ta zëmë, me thirrje për kryerjen e veprës penale.

Një formë e posaçme e kufizimit të lirisë së shtypit mund të prodhohet me rastin e themelimit të medies. Nëse kërkohet leja e organit shtetëror për themelim të medies (**sistemi i lejes**), organ që në mënyrë diskrecionale, me vullnetin vetjak, ndan lejen, atëherë ekziston mundësia për kufizim të lirisë së shtypit, në veçanti i medies që ka prirje opozitare. Kjo tejkalohet ashtu që krijohet standardi i themelimit të lirë të medies, me paraqitje (kërkesë) për regjistrim, pa vendimmarrje diskrecionale të organeve të pushtetit (**sistemi i paraqitjes/kërkesës**).

Liria e shtypit nuk përmendet shprehimisht në **DUDNJ**, por mund të futet në kuadër të lirisë së shprehjes së mendimit (neni 19), për shkak se mendimi shprehet edhe përmes shtypit. Kjo nuk është kështu me **PDCP**, i cili është më i qartë ngaqë shprehimisht i garanton çdo kujt lirinë e shprehjes përmes medieve të ndryshme, liri që mund të kufizohet për arsye të përcaktuara me ligj. Ato janë: respektimi i të drejtave dhe lirisë së të tjerëve, mbrojtja e sigurisë shtetërore, rendin publik, shëndetit dhe moralit (neni 19). **KEDNJ**, njëjtë sikur DUDNJ, lirinë e shtypit e fut nën rubrikën e lirisë së shprehjes të mendimit, pranimit dhe shpërndarjes së informacionit. Shteti nuk mund të përzihet në këtë liri, përveç që mund të kërkojë plotësimin e kushteve për fitimin e lejes për punë të medies. Kjo liri tërheq pas vete përgjegjësinë për fjalën e shqiptuar publikisht, që nënkupton edhe mundësinë për dënim penal për mendimin e shprehur dhe, për pasojë, kufizimin e kësaj lirie. Dënimi dhe kufizimi duhet të jenë të bazuar në ligj, të domosdoshëm në një shoqëri demokratike dhe të bëhen për arsyet si në vijim: interesi i sigurisë nacionale dhe publike, mbrojtja e integritetit territorial, pengimi i çrregullimeve dhe kriminalitetit, mbrojtja e shëndetit, moralit dhe të drejtave të tjerëve, pengimi i zbulimit të informacionit të besueshëm (klasifikuar) dhe me qëllim të ruajtjes së autoritetit dhe paanshmërisë së gjykatës (neni 10).

6.2.3. Liria e asociimit

Merret si e mirëqenë, supozohet, liria e njeriut që, në një shoqëri të lirë, të bashkohet formalisht me të tjerët. Një bashkim i tillë i njerëzve, tre ose më shumë, mund të jetë për motive dhe arsye të ndryshme. Vetëm përjashtimisht e drejta ndalon dhe sanksionon bashkimin me qëllim të realizimit të qëllimeve që janë ligjërisht të ndaluara, siç janë përmbysja e dhunshme e rendit kushtetues dhe kryerja e veprave penale. Liria e asociimit formal nënkupton mundësinë e themelimit të organizatave të interesit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, siç janë: shoqatat dhe organizatat sindikale, ekonomike, bujqësore dhe bashkimeve të tjera joqeveritare (sektori i ojq-ve). Përmes tyre realizohen interesa të ndryshme sociale, shkencore, arsimore, sportive dhe qëllime të tjera. Liria e asociimit si **e drejtë politike** ka kuptim më të ngushtë se kaq dhe ka të bëjë me themelimin e bashkimeve dhe organizatave politike. E thënë thjeshtë, fusha e saj është themelimi dhe veprimi i partive politike dhe organizatave të tjera politike (lëvizjeve, aleancave).

Liria e asociimit nënkupton të drejtën e çdo kujt për të qenë anëtar i një bashkimi apo organizate, por edhe të drejtën për të mbetur jashtë tyre. Partia politike përcakton kushtet e nevojshme për anëtarësim, zakonisht me statut, si dhe arsyet për pushim të anëtarësisë. Një individ mund të jetë anëtar i më shumë shoqatave.

Lirinë e asociimit politik, megjithatë, nuk e gëzojnë të gjithë individët. Të huajt, ta zëmë, zakonisht nuk kanë të drejta politike dhe, për pasojë, as lirinë e asociimit politik. Në këtë mënyrë, formalisht eliminohet e drejta e të huajve, dhe e shteteve të tyre, për të ndikuar në jetën politike të vendit. Shtetasit që kryejnë (ushtrojnë) funksione publike që kërkojnë pavarësi të tërësishme nga politika dhe objektivitet në punë, si dhe të punësuarit në institucione që disponojnë me forcë të armatosur, nuk kanë liri të asociimit. Në këtë mënyrë, në shumicën e shteteve funksionarët e lartë shtetërorë, gjyqtarët dhe prokurorët, nuk mund të jenë anëtarë të partive politike, si dhe avokati i popullit, si mbrojtës i qytetarëve, dhe shërbyesit civilë (publik). Pjesëtarët e ushtrisë dhe policisë (ushtarët, policët, oficerët, pjesëtarët e shërbimit të sigurimit) nuk guxojnë të jenë nën ndikim politik, për arsye se as këta, në shumicën e shteteve, nuk gëzojnë lirinë e asociimit politik.

Kjo liri nuk është e pakufizuar, jo vetëm sa i përket subjekteve që bashkohen, por as në aspektin e qëllimeve për të cilat bashkohen. Konstitucionalizmi krahasimor njeh kufizime të ndryshme të kësaj lirie, për shkak të qëllimeve dhe natyrës së bashkimit: janë të ndaluara partitë politike të ideologjisë naziste dhe fashiste, ndalohen formacionet e armatosura (paramilitare), në disa vende ndalohen edhe organizatat politike me bazë fetare, që avokojnë fundamentalizëm fetar, shoqëritë e fshehta (sekrete), organizatat revolucionare dhe kështu me radhë.

Partitë politike janë forma më e përfaqësuar e organizimit politik dhe produkti më i rëndësishëm i kësaj lirie. Liria e asociimit është qenësore për rendin demokratik sepse qëndron në themel të sistemit shumëpartiak, i cili mundëson që partitë të zëvendësohen në pushtet. Për shkak të kësaj rëndësie, vetë **partitë politike** në një numër të madh të shteteve janë kthyer në **kategori kushtetuese**. Roli dhe statusi i tyre **garantohen me kushtetutë**. Ligjet me pastaj përcaktojnë kushtet për themelimin dhe punën e partive politike, në veçanti mënyrën e financimit të tyre. Për shkak të qëllimeve dhe veprimtarisë mund të ndodhë ndalimi i partisë politike. Kjo mjaft shpesh bie nën juridiksionin e gjykatave kushtetuese. Në praktikë shumë shpesh ka ardhur deri te ndalimi i partive të së majtës ekstreme dhe të së djathtës ekstreme, si dhe të atyre me bazë islamin politik (nga vitit 1945 deri në vitin 2019: në Kroaci një, në Gjermani dy, në Francë gjashtë, në Turqi gjashtëmbëdhjetë).[34]

Liria e asociimit garantohet së bashku me **lirinë e tubimit**. Përkundër asaj që bëhet fjalë për liri të ngjashme, që nënkuptojnë shprehjen e mendimit dhe ndërmarrjen e veprimeve me qëllim të arritjes së qël-

[34] Slobodan P. Orlović: *Ustavno parvo* (Pravni fakultet Univerziteta u Novom Sadu: Novi Sad, 2019), fq. 105.

limit të caktuar politik, ato, megjithatë, nuk janë të njëjta. Liria e tubimit është e drejta e mbledhjes së më shumë njerëzve në një hapësirë të mbyllur ose të hapur, e drejta për formim të rreshtave për qëllim të demonstrimit, shprehjes publike të qëndrimeve dhe kërkesave. Qëllimi i tubimit mund të jetë politik, siç është mitingu zgjedhor me qëllim të fitimit të votave apo kritika e një politike apo mase qeveritare me qëllim të ndërrimit të qeverisë. Tubimi mund të ketë qëllim arritjen edhe të qëllimeve të tjera, të natyrës ekonomike ta zëmë, siç janë tubimet e sindikatave apo punëtorëve, protestat kundër krimit, por edhe mund të jenë ngjarje thjeshtë sportive dhe kulturore.

Shteti mund ta kufizojë këtë liri për arsye të sigurisë (vlerësimi negativ i sigurisë) apo shkaku i rrezikimit të lirive dhe të drejtave të personave të tjerë, siç është rasti, ta zëmë, me funksionimin e komunikacionit. Pushteti publik ka detyrim të përkujdesjes mbi sigurinë e demonstruesve dhe pjesëmarrësve të tjerë në tubim. Për tubim të ligjshëm mjafton vetëm lajmërimi i tubimit, por ka raste kur mund të ketë nevojë detyrimisht për marrjen e lejes. Në dy situatat, tubimi duhet të jetë paqësor, siç thuhet në **DUDNJ**, që nënkupton pa armë.

DUDNJ-ja i njeh çdo kujt të drejtën për tubim dhe asociim paqësor dhe të drejtën për të qëndruar jashtë bashkimit: askush nuk mund të detyrohet për të qenë anëtar i një bashkimi (neni 20). Në këtë akt të rëndësishëm juridik-ndërkombëtar, tubimi dhe asociimi normohen së bashku, sepse kjo e fundit konsiderohet formë joformale e lidhjes së qytetarëve që realizohet me qëllim të shprehjes publike të mendimit dhe arritjes së një qëllimi. **PDCP-ja** ndan asociimin nga tubimi. Çdo kujt i garantohet e drejta për asociim me të tjerët, në veçanti theksohet **liria e organizimit sindikal** me qëllim të mbrojtjes së interesave. Ky dokument parashikon mundësinë e kufizimit ligjor të kësaj të drejte, po vetëm nëse një gjë e tillë është e nevojshme në një shoqëri demokratike me qëllim të mbrojtjes së interesit të sigurisë nacionale dhe publike, rendit publik, shëndetit dhe moralit, lirive dhe të drejtave të personave të tjerë. Në veçanti lejohet mundësia e kufizimit të lirisë së asociimit të anëtarëve të forcave të armatosura dhe policisë, kurse mbrohet liria e organizimit sindikal (neni 22). Garantohet liria e tubimit, që duhet të jetë paqësor. Ajo mund të kufizohet nën të njëjtat kushte si edhe liria e asociimit, mirëpo nuk përcaktohen kufizimet për anëtarët e forcave të armatosura dhe policisë.

Edhe **KEDNJ-ja** së bashku normon lirinë e tubimit dhe asociimit. Tubimi garantohet vetëm kur është paqësor, kurse te asociimi posaçërisht vihet theksi në themelimin e sindikatave dhe anëtarësimin në to me qëllim të realizimit të interesave. Kufizimet janë të njëjta si për tubim ashtu edhe për asociim – duhet të jenë të caktuara me ligj dhe të jenë të domosdoshme në një shoqëri demokratike. Arsyet për një gjë të tillë kanë të bëjnë me: mbrojtjen e sigurisë nacionale dhe publike, pengimi i çrregullimeve dhe kriminalitetit, mbrojtja e shëndetit, moralit ose të drejtave dhe lirive të tjerëve. Edhe këtu theksohet në mënyrë të veçantë se liria e tubimit dhe asociimit mund të kufizohet për anëtarët e forcave të armatosura, policisë dhe administratës shtetërore (neni 11).

6.3. Liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore

Liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore pranohen më vonë se liritë dhe të drejtat personale. Kjo gjeneratë e të drejtave dhe lirive njerëzore kërkon aktivitet të shtetit (**të drejtat të statusit aktiv**), sepse pa veprim shtetëror këto nuk mund të realizohen dhe ngelin proklamata boshe.

Para njohjes dhe përqafimit të tyre, në kalimin nga shek. XIX në shek. XX, shteti detyrimisht ka ndryshuar rolin e vet shoqëror dhe natyrën. Sa i përket rolit të shtetit, ai ka ndryshuar ashtu që nga një shtet që dikur anonte kah sfera e lirive dhe të drejtave si një sferë private që u takon vetëm qytetarëve, në një shtet që ka rolin e ndihmësit në realizimin e lirive dhe të drejtave njerëzore. Natyra e shtetit, ndërkaq, ka ndryshuar në kuptimin që ai më nuk është bashkësi politike dhe juridike, e rregulluar nga e drejta (me norma juridike) dhe me pushtet politik, por një bashkësi e natyrës shoqëroro-ekonomike, në të cilën të gjithë qytetarët plotësojnë nevojat e tyre ekonomike, sociale dhe kulturore. Dy këto ndryshime kanë ar-

dhur si pasojë e përqafimit të një ideologjie tjetër – ideologjia socialdemokratike, pra si pasojë e kalimit nga **ideologjia e shtetit liberal** në **shtetin e ideologjisë socialdemokratike**. Me insistimin në barazinë formale, lirinë ekonomike dhe lirinë kontraktuese, liberalizmi nuk prodhoi barazinë e premtuar dhe të dëshiruar. Rregullimi kushtetues liberal po i shërbente klasave të privilegjuara sepse legjislacioni bazohej në census material dhe diskriminim gjinor e racor. Një gjë e tillë bënte që ligjet dhe sistemi juridik të mbronin interesat e vetëm një shtrese, asaj borgjeze, dhe segmenteve të caktuara të popullsisë, duke përjashtuar një pjesë të madhe të saj. Kjo gjendje kërkonte rishikimin urgjent të kushtetutave liberale të kohës me qëllim të adresimit të problemeve sociale që ishin prodhuar si rezultat i pabarazisë substanciale (materiale) shoqërore. Pikë kthimi në këtë aspekt shënon viti 1848, një vit ky i përmbysjeve sociale në **Evropë**, përmbysje që në fund të shekullit XIX u kurorëzuan me aktualizimin dhe ngritjen e shtetit social.[35]

Këto ndryshime në rolin dhe pozitën e shtetit në shoqëri, në një masë të madhe kanë kontribuar në ruajtjen nga shpërbërja e shteteve liberale. Konfliktet në rritje në mes të grupeve shoqërore, ta zëmë, në mes të punëdhënësve dhe punëtorëve, të shkaktuara nga liberalizmi ekonomik, kanë mundur të zgjidhen vetëm me ndërhyrjen e shtetit. Ky angazhim i shtetit ka nënkuptuar garantimin me kushtetutë të lirive dhe të drejtave më të rëndësishme ekonomike dhe sociale, më pas edhe atyre kulturore, ashtu që mbrohen individët që janë më të dobët ekonomikisht – punëtorët në raport me punëdhënësit kapitalistë, pastaj personat e paaftë për punë, të moshuarit, të sëmurët, fëmijët. Kështu, shteti nis të përkujdeset mbi zhvillimin fizik dhe arsimor të popullatës dhe mbi nevojat kulturore të krejt kombit.

Ndryshimi i rolit dhe pozitës së shtetit, megjithatë, nuk është kusht i mjaftueshëm por i domosdoshëm për realizimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore. Krahas vullnetit shtetëror të shprehur për garantimin e këtyre të drejtave, kusht kryesor (thelbësor) për realizimin e tyre është që shteti të jetë mjaftueshëm i pasur, të ketë mjete me bollëk. Kjo është kështu sepse vetëm pasuria e mjaftueshme mund të garantoj implementimin efektiv të lirive dhe të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore. Nëse ky nuk është rasti, siç është sot me shumicën prej vendeve të botës, atëherë këto të drejta, përkundër që janë të garantuara, ngelin në masë të madhe proklamime boshe.

Subjekte të lirive dhe të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore janë qytetarët e statusit të caktuar, i cili i radhitë ata në kolektivitet formal (të regjistruar) dhe joformal. Këto kolektivitete përbëhen nga kategoritë, ta zëmë, për sa vijon: personat e rrezikuar shoqërisht (të drejtat sociale), studentët (të drejtat arsimore), të punësuarit (të drejtat lidhur me punën), anëtarët e sindikatës (e drejta në aktivitete sindikale) dhe qytetarët tjerë që kanë cilësinë e të punësuarit, të papunësuarit, të rrezikuarit shoqërisht, nxënësit, krejt këto si cilësi mbi bazën e të cilave ata realizojnë disa nga të drejtat dhe liritë e tyre ekonomike, sociale dhe kulturore. E thënë edhe më qartë, me këto të drejta mbrohet pozita shoqërore e individit, përkatësisht dinjiteti i njeriut të pavarur ekonomikisht, i siguruar shoqërisht, mjaftueshëm i arsimuar, pjesëmarrës i shëndosh i jetës kulturore.

---

[35] Ky shtet është i ndryshëm nga **shteti klasik liberal**, që duhej të rrinte anash dhe të kishte angazhim minimal në jetën shoqërore (liria negative). Kjo nënkupton se shteti social, i kundërt tërësisht me shtetin klasik liberal, merr përgjegjësinë parësore për plotësimin e nevojave të popullit nën juridiksionin e tij (shteti liberal më parë kishte pasur detyrime vetëm ndaj shtetasve). Këto nevoja kishin të bënin, në veçanti, me njerëz me nevoja të posaçme (të sëmurët, handikapatët, të papunësuarit). Motivet e thella të këtij shteti ishin referimet në idetë e barazisë dhe drejtësisë sociale – ideologjia socialdemokratike. Kjo nënkupton ndërhyrje shtetërore që garanton të drejtat e gjeneratës së dytë (të drejtat sociale, ekonomike dhe kulturore) dhe formimin e një sektori të madh publik, qeverisja e të cilit ka për pasojë miratimin e një rregullative juridike përmasash të mëdha. Kjo rregullativë e madhe nuk do të thotë se shteti social bazohet në sundimin e ligjit, në kuptimin e ngushtë të fjalës, por në sundimin e rregullit të arsyes dhe barazisë, përkatësisht në sundimin e arsyes dhe barazisë përmes ligjit. Cf. më shumë për **shtetin social**, lindjen dhe zhvillimin e tij në kontekstin krahasimor, me theks të veçantë në vendet skandinave, në librin hulumtues dhe teorik të redaktuar nën udhëheqjen e Martin Scheinin (ed.), *Welfare State and Constitutionalism – Nordic Perspectives* (Nordic Council of Ministers: Copenhagen, 2001).

Janë miratuar akte ndërkombëtare që globalisht dhe regjionalisht rregullojnë të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore. Qëllimi i tyre është përmirësimi standardit jetësor të qytetarit dhe përparimi i mirëqenies së përgjithshme shoqërore në vendet që i kanë përqafuar. Para tyre kanë ekzistuar deklarata e kushtetuta, me të cilat janë garantuar këto liri dhe të drejta, u mor vesh jo në shkallën që sot garantohen. Si kushtetutë e parë e këtij lloji merret **Kushtetuta e Vajmarit** (1919), e cila, krahas lirive klasike, futi edhe të drejtat sociale dhe ekonomike si dhe një sërë dispozitash udhëzuese lidhur me rendin ekonomik. Në rend të parë, dinjiteti shfaqet si një nocion kushtetues, në kuptimin e të drejtës për të pasur një jetë dinjitoze, e siguruar dhe përforcuar përmes të drejtës për strehim, ushqim dhe veshmbathje.[36] Në mënyrë të njëjtë dinjiteti parashikohej edhe në **Kushtetutën e Irlandës**,[37] kurse një kapitull gjithëpërfshirës mbi rendin social dhe ekonomik e hasim edhe në **Kushtetutën e Brazilit**,[38] që të dyja të miratuara pas Vajmarit. Në literaturë përmendet si kushtetutë e kësaj natyre edhe **Kushtetuta e Meksikës** e vitit 1917,[39] **Kushtetuta e Rusisë Sovjetike** e vitit 1918 dhe, shumë më herët **Kushtetuta e Meksikës** e vitit 1824. Në kategori të njëjtë hyn edhe **Kushtetuta e Francës** e vitit 1848, e cila ka pasur në dispozitat e saj elementin social, me qëllim të adresimit të të metave të liberalizmit.[40] Kjo Kushtetutë jetëshkurtër parashikoi të drejtën për punë, kurse në preambulën e vet premtonte një shpërndarje më të drejtë të barrës dhe privilegjeve të qytetarëve. Pati një kartë të të drejtave që garantonte arsimimin e lirë, barazinë në marrëdhëniet e punës, punë publike për të papunësuarit, ani se nuk garantonte të drejtën për punë, ndihmën e shtetit për të sëmurët dhe ata që nuk ishin në gjendje të kujdeseshin për vetveten. Kjo Kushtetutë shënon fazën fillestare të futjes në sistem të elementit social të moderuar, që nuk synon përmbysjen e sistemit kushtetues liberal, por reformimin dhe korrigjimin e tij në aspektet kryesore sociale. Tani e tutje, shteti duhej të ndërhynte për sigurimin e mirëqenies minimale sociale dhe të pengonte abuzimin e lirive ekonomike në kurriz të shtresave të varfëria të shoqërisë. Forma e radikale e shtetit social, ku në tërësi mohohet sistemi ekzistues liberal, duke e parë atë si negacion të lirisë dhe barazisë njerëzore, janë **shtetet socialiste.** Këto vende nuk kënaqeshin me formën,

---

36 Seksioni V [“Jeta Ekonomike“] i **Kushtetutës së Vajmarit**. *Constitution of Weimar* (1919). Në internet: https://digital.library.cornell.edu/catalog/nur01840 (shikuar në mars 2021). Për komentet, cf. më shumë në Young-Sun Hong, *Welfare, Modernity, and the Weimar State* (Princeton University Press: Princeton, 2016).

37 Neni 45 [“Parimet Udhëzuese të Politikës Sociale“] i **Kushtetutës së Irlandës** (1937). *Constitution of Ireland* (1937). Në internet: http://www.irishstatutebook.ie/eli/cons/en#part14 (shikuar në prill 2022). Për komente, cf. më shumë në Adrian Kelly, “Catholic Action and the Development of the Irish Welfare State in the 1930s and 1940s”. *Archivium Hibernicum*. Vol. 53 (1999) fq. 107-117 (autori diskuton ndërvarshmërinë në mes të Kishës Katolike dhe Shtetit të Mirëqenies, që u krijua në vitet ’30 të shekullit të kaluar, bazuar në Kushtetutën e vitit 1937); Thomas Morray, “Socio-Economic Rights and the Making of the 1937 Irish Constitution” *Irish Political Studies* Vol. 31 Issue 4 (2016) fq. 502-524 (të drejtat socio-ekonomike kanë figuruar shumë lartë në procesin e kushtetutëbërjes që çoi në krijimin e Kushtetutë së vitit 1937; kjo për arsye të ngritjes së rëndësisë së klasave gjatë Depresionit të Madh; në Irlandën e viteve ’30 të shekullit të kaluar, betejat e ndryshme të fshatarëve punëtorëve dhe grave për të drejtat e tyre kishin bërë që republikanët, komunistët, feministët dhe sindikalistët e punëtorëve të krijojnë programe e kushtetuta të ndryshme; si përgjigje ndaj këtij mobilizimi social, kushtetutëbërësit artikuluan një formë shumë selektive të konstitucionalizmit “social-katolik”; në këtë mënyrë, Kushtetuta e vitit 1937 i la të paprekur ligjet ekzistuese të tregut duke ofruar një të drejtë familjare të dallueshme në aspektin kombëtar; kjo ishte bërë në mbrojtje të ekonomisë politike agrare të periferisë së vendit dhe lëshimin e përpjekjeve shtetërore për mirëqenie në duart e Kishës Katolike).

38 Titulli IV [“Të Drejtat Ekonomike dhe Sociale“] i **Kushtetutës së Brazilit** (1937). *República Federativa de Brasil/ Federative Republic of Brazil. Constitución Política de 1934. 1934 Constitution.* Në internet: https://pdba.georgetoën.edu/Constitutions/Brazil/brazil34.html (shikuar në prill 2022). Për komente dhe kontekstin historik të krijimit të Kushtetutës së vitit 1937, cf. më shumë në Ernest Hambloch, “The New Régime in Brazil”. *Foreign Affairs* Vol. 16, No. 3 (Apr., 1938), fq. 484-493.

39 Cf. më shumë në Fábio Konder Comparato, “The Economic Order in the Brazilian Constitution of 1988” *The American Journal of Comparative Law* Vol. 38, No. 4 (Autumn, 1990) fq. 753-771 (autori diskuton për kushtetutën ekonomike të Brazilit, koncept që lindi me **Kushtetutën e Vajmarit**, dhe shtjellon edhe periudhën e para **Luftë së Dytë Botërore**, duke përfshirë në mënyrë krahasuese edhe **Meksikon** dhe gjendjen e vendeve të **Amerikës Latine** në këtë kohë; ideja e rolit intervencionist të shtetit lidhet me gjendjen e përgjithshme ekonomike të këtyre vendeve dhe intensifikimin e konfliktit social si pasojë e krizës ekonomike që u krijua pas Luftës së Parë Botërore).

40 Cf. më shumë për historikun e këtij revolucioni dhe zhvillimet tjera kushtetuese dhe politike në John Horne, “1848 and the Language of Politics”. *Saothar* Vol. 25 (2000) fq. 67–76.

por kërkonin përmbysjen e tërësishme të rendit liberal, gjë që u reflektua në të gjitha **kushtetutat e vendeve socialiste**.[41]

Prej deklaratave vlen të përmendet **Deklarata e Popullit Punues dhe të Eksploatuar**, e cila ndryshoi natyrën e deriatëhershme të shtetit rus, të cilin e shndërroi në pronar të të gjitha të mirave – tokës, fabrikave, xeheroreve, hekurudhave, bankave dhe kështu me radhë. Kjo ishte krejtësisht e kundërt me Deklaratën e 1789: me këtë Rusia sovjetike nuk pati për synim krijimin e mjeteve materiale për realizimin e të drejtave dhe lirive ekonomike, sociale dhe kulturore, aq më pak të atyre civile dhe politike, por realizimin e ideologjisë komuniste të diktaturës së proletariatit dhe implementimin e inxhinieringut social komunist. Kjo Deklaratë pati ndikim edhe në shtetet tjera ish-komuniste, të cilat, siç u tha, në tërësi mohuan standardet liberale të konstitucionalizmit modern, duke u orientuar më rolin e fuqishëm të shtetit të diktaturës së proletariatit si transformues të krejt shoqërisë. **DUDNJ-ja**, si deklaratë e radhës, garanton një sërë të drejta të gjeneratës së dytë: të drejtën në sigurimin social, në punë, për themelim të sindikatës, për standard jetësor, arsimim, pjesëmarrje në jetën kulturore (nenet 22-27). Deklarata garanton edhe të drejtën në pasuri si e drejtë themelore ekonomike dhe personale (neni 17). Këto të drejta, në mënyrë më të detajuar i normon **PDESK**-ja, kurse në shtetet evropiane vlen **Konventa Evropiane Sociale** (1961, me amendamentet e vitit 1996).

Në shtete, të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore normohen me kushtetuta, në pjesën që ka të bëjë me liritë dhe të drejtat e njeriut. Dispozitat kushtetuese vetëm parimisht normojnë këto të drejta, duke ridërguar (referuar) çështjen në ligje, si akte që normojnë në detaje këto të drejta e liri. Për këtë arsye, sipas kriterit të aktit që normon përmbajtjen e tyre, mund të thuhet se këto janë të **drejta ligjore**. Kështu ekzistojnë ligjet si: për punën, kulturën, arsimin, mbrojtjen sociale, mbrojtjen shëndetësore. Nuk ka dispozita kushtetuese që autorizojnë ligjvënësin për normim të mëtejmë të lirive dhe të drejtave kushtetuese më shumë se ato që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore.

6.3.1. E drejta për punë dhe të drejtat tjera lidhur me punën

E drejta për punë është e drejtë themelore ekonomike. Kjo nënkupton se qytetarët me kryerjen e punës realizojnë nevojat e tyre ekonomike dhe nevojat e anëtarëve të familjes së tyre. E drejta për punë, në kuptimin e ngushtë të fjalës, është e drejtë deklarative, sepse shteti nuk ka detyrim sigurimin e punës për çdo kënd. Një natyrë si kjo e të drejtës për punë nënkupton që, si e tillë, ajo nuk mund të realizohet përmes rrugëve gjyqësore. Kuptimi konkret i të drejtës për punë do të thotë se secili individ, në kushte të barabarta, të konkurroj për punë dhe të punësohet. Kjo përfshinë edhe të drejtën për qasje të barabartë për punësim në shërbimet shtetërore (në këtë aspekt, pjesërisht është e drejtë politike). E kundërt me të drejtën për punë është papunësia: realizimi më i madh i të drejtës për punë zvogëlon papunësinë dhe anasjelltas.

Të drejtat tjera lidhur me punën realizohen me pastaj, pas themelimit të marrëdhënies së punës, që përfaqëson marrëdhënien në mes të punëdhënësit dhe të punësuarit dhe ngërthen të drejta dhe detyrime reciproke, siç janë: rroga (pagesa), pushimi, greva etj. Të gjitha të drejtat pas themelimit të marrëdhënies së punës, si dhe e drejta për themelimin e marrëdhënies së punës në kushte të njëjta, **janë të drejta të mbrojtura** dhe **të realizueshme përmes rrugës gjyqësore**. Në mënyrë të posaçme realizohet e drejta për punë në profesionet e pavarura, ta zëmë në avokaturë.

Realizimi i të drejtave në bazë të drejtës për punë varet nga **stabiliteti** dhe **permanenca** e marrëdhënies së punës. Si një element i qenësishëm i të drejtës për punë, permanenca mungon në shumicën e vendeve. Në të gjitha vendet, veçanërisht në vendet në zhvillim apo në tranzicion, stabiliteti marrëdhënies

[41] Cf. më shumë në George C. Guins, "Moscow's European Satellites". *The Annals of the American Academy of Political and Social Science* Vol. 271, (Sep., 1950), fq. 64-67; Dieter Grimm, "Integration by Constitution" *International Journal of Constitutional Law* Vol. 3 Issue 2-3 (May 2005) fq. 193-208 në fq. 125.

së punës varet nga ajo se kush është punëdhënës: të punësuarit në shërbimet shtetërore dhe në përgjithësi në sektorin publik janë në pozitë më të mirë në krahasim me të tjerët që janë të punësuar te punëdhënësit privatë. Të drejtat në bazë të punës përfshijnë edhe të drejtat pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Ato janë të drejta që rrjedhin nga sigurimi për rastet e papunësisë, përkatësisht për situatat e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, dhe atë të drejtat për mbrojtje të shëndetit dhe kompensim të dëmit material.

E drejta për punë është një e drejtë komplekse njerëzore, që përbëhet nga disa të drejta dhe liri. Si pikë nisëse është liria e punës: puna është e lirë dhe me vullnet, kurse puna e detyrueshme ndalohet rreptësisht. Çdo kush është i lirë të zgjedh profesionin, atë që do të punojë. Për zgjedhjen me dëshirë të profesionit kërkohet plotësimi i kushtit të pasjes së arsimimit dhe profesionit përkatës si dhe vite të jetës. Kushti i fundit ekziston sepse ndalohet puna e fëmijëve. Themelimi i marrëdhënies së punës, apo kryerja e punës me pagesë në një formë tjetër juridike, paraqet bazën e të drejtës për mbrojtje dhe siguri në punë, higjienë dhe kushte të shëndetshme në punë, sigurimi i kushteve të posaçme në punës në vendet e rrezikshme të punës, pastaj kufizimet e kohës së punës dhe e drejta për pushim dhe kompensim material për punën e kryer. Sa i përket marrëdhënies së punës, në veçanti mbrohen gratë, nënat, të miturit dhe invalidët.

Nga shumë të drejta lidhur me punën mund të veçojmë disa syresh. Shumica prej tyre janë fituar me luftë kolektive të punëtorëve për më shumë të drejta dhe kushte më të mira për punë. **E drejta për pushim** ditor, javor dhe vjetor me pagesë, garantohet me akte juridike. Puna nuk mund të kryhet fizikisht nëse i punësuari nuk realizon të drejtën për pushim. **E drejta për ndihmë materiale** për shkak të sëmundjes, invaliditetit permanent për punë dhe papunësisë si dhe e drejta për pension për shkak të moshës dhe plotësimit të stazhit të punës, janë të drejta që rrjedhin nga e drejta për punë. **E drejta për grevë** përfaqëson kërcënim me ndalje, ndërprerje të pjesshme apo ndërprerje të plotë të punës, me qëllim të realizimit të kushteve më të mira për punë, ta zëmë, me qëllim të rritjes së rrogës (pagesës). Këtë të drejtë e gëzojnë krejt të punësuarit, kurse mund të kufizohet për të punësuarit në shërbime publike nga të cilat varet siguria e shtetit, shëndeti i qytetarëve dhe të drejtat tjera të tyre. Këtu hyjnë, sipas rregullit, kategoritë si vijon të të punësuarve: ushtria, policia, gjyqësori, personeli shëndetësor. Aktualisht greva njihet me kushtetuta si një mjet legjitim për realizimin e të drejtave të të punësuarve, kurse ka lindur si rezultat i mjerimit ekonomik dhe eksploatimit të madh të punëtorëve nga ana e punëdhënësve në fillet e kapitalizmit. Në disa vende ekziston edhe instituti i a.q. **lockout**, ndërprerja e punës nga punëdhënësi kur nuk mund të merret vesh me sindikatën. **E drejta për themelimin** e sindikatave nënkupton bashkimin e të punësuarve në sindikata, të cilat përfaqësojnë interesat e tyre, si ndaj punëdhënësit ashtu edhe ndaj ligjvënësit dhe shtetit. Edhe kjo e drejtë, njëjtë si e drejta për grevë, përfaqëson një formë të luftës për të drejtat e të të punësuarve, që nga koha e revolucionit të parë industrial (shek. XVIII). Një numër i madh i të punësuarve, megjithatë, nuk shfrytëzon të drejtën e bashkimit sindikal (në vendet evropiane vlerësohet se 10 deri 20 % e të punësuarve janë të organizuar në sindikata, kurse në vendet skandinave shumë më shumë, rreth 70 %), kurse vetë organizatat sindikale janë të shumta në numër dhe të pa organizuara. Sindikata reprezentative, me numër të mjaftueshëm të anëtarëve, ta zëmë me 20 %, merr pjesë në bisedat me punëdhënësit për realizimin e të drejtës për **kontratë kolektive**. E drejta për punë është e drejtë njerëzore, përmbajtja e së cilës normohet me kushtetutë vetëm në një pjesë të vogël. Me legjislacionin e punës konkretizohen dispozitat kushtetuese dhe iu jepen më shumë të drejta të punësuarve. Të drejtat e punës kanë një specifikë që konsiston në atë se, me akte të fuqisë më të ulët juridike, **kontratat kolektive**, që burojnë nga bisedat në mes të punëdhënësve dhe përfaqësuesve të të punësuarve, të drejtat e garantuara ligjore mund të zgjerohen edhe më shumë.

DUDNJ-ja garanton të drejtën për punë dhe të drejta të tjera: lirinë e zgjedhjes së punësimit, kushte të drejta dhe të përshtatshme të punës, mbrojtje nga papunësia, pagesën e njëjtë për punën e njëjtë, e cila, krahas kësaj, është e drejtë aq sa të sigurojë ekzistencën e të punësuarit dhe familjes së tij, e drejta për bashkim sindikal, e drejta për punë në kohë të kufizuar, pushim me pagesë, rekreacion (nenet 23-24).

PDESK-ja në mënyrë më të detajuar rregullon të drejtën për punë dhe të drejtat në lidhje me punën, në veçanti të drejtën për bashkim sindikal (nenet 6-8). Shtetet duhet të ndërmarrin masa për realizimin e plotë të kësaj të drejte – arsimimin e orientuar, aftësimin profesional, zhvillim ekonomik. **KSE-ja** përcakton kushtet për realizimin efektiv të së drejtës për punë, që përfshijnë: punësimin, kushtet e punës, kompensimin e drejtë, organizimin mbi baza interesi i punëdhënësve dhe të të punësuarve, bisedimet kolektive, të drejtat e posaçme të fëmijëve, rinisë dhe grave, e drejta për orientim dhe aftësim profesional (nenet 1-10).

Nga të drejtat ekonomike këtu do të përmendim edhe të drejtën për pasuri, e cila nuk garantohet me tekstin burimor të **PDESK-së** dhe **KSE-së**, por vetëm me **DUDNJ-në**. Ky dokument çdo kujt i garanton se nuk mund të privohet arbitrarisht nga pasuria që posedon (neni 17). Për nga natyra e saj, kjo e drejtë është ekonomike, sepse pasuria përfshinë pasurinë e tundshme dhe të patundshme dhe aktiven (kërkesat nga puna etj.). E drejta për shfrytëzim të pasurisë private, megjithatë, ka edhe dimensionin e vet politik për shkak se është themel i sistemit politik. Kjo e drejtë, kryesisht, dhe mbi të gjitha normohet me legjislacionin civil, por është edhe e drejtë personale ngaqë mundëson realizimin e të drejtës në jetë, dinjitet dhe zhvillim të personalitetit. Kjo e drejtë nuk është e pakufizuar. Mund të kufizohet dhe merret krejt kundrejt një kompensimi të drejtë monetar ose një ekuivalenti tjetër, nëse kjo është në interes publik, për çka kërkohet vendim i posaçëm i organit të pavarur të pushtetit.

6.3.2. E drejta për mbrojtjen e shëndetit

E drejta për mbrojtjen e shëndetit përfshinë mbrojtjen fizike dhe psikike të individit, përmes parandalimit, diagnostifikimit dhe shërimit, si dhe të drejtën për kushte të shëndetshme jetësore. Këto kushte përfshijnë hapësirën e duhur për banim, higjienën dhe ushqimin. E drejta për mbrojtjen e shëndetit është e drejtë themelore njerëzore, por në të njëjtën kohë edhe interes shtetëror për të pasur popullsi të shëndoshë (të aftë në pikëpamje shëndetësore). Nga shëndeti i qytetarëve varet realizimi i lirive dhe të drejtave tjera, siç janë: e drejta për punë, për arsim, por edhe për prosperitet të shtetit përmes zhvillimit ekonomik dhe kulturor dhe siguri.

E drejta për mbrojtjen e shëndetit bën pjesë në ato të drejta, realizimi i të cilave në masë të madhe varet nga shteti. Dallohen dy kushte për realizmin e plotë të kësaj të drejte: e para, ekzistimi i politikës shtetërore, që nënkupton mbrojtjen shëndetësore nga fondet publike për të gjithë qytetarët; dhe, e dyta, ekzistimi i mundësisë reale materiale të shtetit për të ofruar mbrojtje të shëndetit për të gjithë qytetarët e vet. Për realizimin e plotë të kësaj të drejte duhet të plotësohen dy këto kushte.

Për të drejtën për shëndet në **DUDNJ** flitet në kuadër të drejtës për standard jetësor, i cili, në mes tjerash, siguron shëndetin e qytetarëve dhe familjeve të tyre, përkujdesjen mjekësore, sigurimin në rast të sëmundjes dhe invaliditetit. Në veçanti mbrohen nënat dhe fëmijët (neni 25). **PDESK-ja** pranon të drejtën e çdo kujt për shëndetin më të mirë fizik dhe psikik dhe përcakton masat që shtetet duhet të ndërmarrin për të arritur këtë qëllim, siç janë: ulja e vdekshmërisë së foshnjave të sapolindura dhe zhvillim i shëndetshëm i fëmijëve, përmirësimi i kushteve ekonomike e të jetës dhe punës, pengimi i sëmundjeve ngjitëse dhe sëmundjeve të tjera, qasja në shërbimet mjekësore dhe përkujdesje mjekësore në rast të sëmundjes (neni 12). Në **KEDNJ** e drejta për mbrojtjen e shëndetit paraqet një detyrim për shtetet anëtare për të vepruar në eliminimin e shkaqeve të rrënimit të shëndetit, ndërmarrjen e masave për përparimin e shëndetit, pengimi i sëmundjeve ngjitëse dhe sëmundjeve të tjera (neni 11).

Në kushtetuta e drejta për shëndet më së shpeshti i garantohet çdo kujt, si një garancion i përgjithshëm. Kjo do të thotë se shteti, vetëm ose me organizata private shëndetësore, organizon sistemin shëndetësor në të cilat bëhet mbrojtja e shëndetit. E drejta për mbrojtjen e shëndetit nënkupton edhe dhëniet materiale të qytetarëve për kujdes dhe shërbime mjekësore, në formë të sigurimit shëndetësor apo participimit (pagesës së pjesshme) për shërbimin konkret shëndetësor. E drejta për shëndet në disa kushtetuta nënk-

upton edhe mbrojtjen shëndetësore pa pagesë, zakonisht kategorive të caktuara të personave, siç janë: nënave, fëmijëve, të moshuarit, invalidët.

Me qëllim të realizimit të së drejtës për mbrojtjen e shëndetit miratohen ligjet, me të cilat saktësohet përmbajtja e kësaj të drejte, kushtet e sigurimit shëndetësor, mënyrat e financimit të mbrojtjes shëndetësore, rrjeti i institucioneve shëndetësore (spitalet, institutet, senatoriumet etj.).

Nga të drejtat sociale, me këtë rast përmendim edhe të **drejtën për siguri sociale**. Kjo e drejtë garantohet me akte ndërkombëtare për secilin anëtar të shoqërisë (neni 22 i **DUDNJ-së**; neni 9 i **PDESK-së**; neni 12 i **KSE-së**. Sigurimi social nënkupton të drejtën në dhënie materiale personave ndaj të cilëve janë krijuar rrethanat e siguruara, ta zëmë, kompensimi për personat e papunësuar për shkak të humbjes së punës, fëmijët, të moshuarit, të gjithë të tjerët që nuk kanë mjete të nevojshme për jetë. Me të drejtën për siguri sociale shteti tregon kujdes të posaçëm për nënat dhe fëmijët.

6.3.3. E drejta për arsim

E drejta për arsimim është e drejtë brenda grupit të të drejtave kolektive dhe nënkupton zhvillimin e personalitetit përmes fitimit të niveleve të ndryshme të arsimimit, nga shkolla fillore, përmes të mesmes e deri në arsimimin e lartë. Kjo është një e drejtë individuale, e cila, nën kushte të barabarta, i takon çdo kujt dhe mund të jetë edhe e detyrueshme. Gjatë procesit të arsimimit, personi fiton edhe disa të drejta të caktuara kolektive, në bazë të faktit që fiton statusin e nxënësit ose studentit.

Shteti përkujdeset në realizimin e të drejtës për arsim, sepse më këtë përparohen marrëdhëniet e mirëkuptimit në mes të njerëzve, arrihet mirëqenia e përgjithshme dhe ndihmohet realizimi i të drejtave të tjera njerëzore (e drejta për punë, krijimtari kulturore, liria e shprehjes). Përveç këtij garancioni të përgjithshëm, e drejta për arsim përfshinë një sërë lirish dhe të drejtash që kanë të bëjnë me personat në procesin arsimor, me ata që e implementojnë, si dhe me vetë mësimin dhe institucionet arsimore. E drejta për shkollim pa pagesë realizohet në të gjitha tri nivelet, në ndërkohë që shkollimi fillor është i detyrueshëm. Prindërit/kujdestarët kanë drejtë të zgjedhin llojin e shkollimit për fëmijët e tyre, por janë edhe bartës të detyrimit të shkollimit të tyre të detyrueshëm.

Tri nivelet e arsimit janë të qasshme për të gjithë, nën kushtet të barabarta. Kjo e drejtë përfshinë edhe të drejtën për financim (bursim) të shkollimit. Të drejta të posaçme lidhur me shkollimin mund të kenë anëtarët e **pakicave kombëtare**, të cilave iu garantohet e drejta e shkollimit në gjuhën amtare, sipas planprogrameve të posaçme arsimore, në disa vende edhe në institucionet arsimore për pakicat.

E drejta për arsim përfshinë lirinë e mësimit, brenda planeve dhe programeve të miratuara (përqafuara). Liria e mësimit mbrohet në mënyrë të veçantë përmes të drejtës për **autonomi të universiteteve dhe institucioneve të shkollimit të lartë**, të cilat vendosin në mënyrë të pavarur për mësimin dhe punën e vet.

E drejta për arsim përfshinë lirinë e përzgjedhjes së institucionit arsimor, si në pronësi private ashtu edhe në pronësi publike, si dhe përzgjedhjen e shkollave dhe fakulteteve të ndryshme. E drejta për arsim ngërthen edhe të drejtën për arsimim fizik dhe sport, e cila, në anën tjetër, është e lidhur me të drejtën për shëndet.

DUDNJ-ja ia njeh çdo kujt të drejtën për shkollim pa pagesë në shkollë fillore dhe shkollim të ulët. Shkolla fillore është e detyrueshme, kurse nivelet e larta të shkollimit janë të qasshme përgjithësisht ose nën kushte të barabarta në bazë të kriterit të barazisë së të gjithëve. Prindërit/kujdestarët kujdesen për shkollimin e fëmijëve të tyre. Me shkollim duhet të nxitet zhvillimi i personalitetit, respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut, mirëkuptimi, toleranca dhe miqësia në mes të popujve, grupeve racore e fetare dhe ruajtja e paqes (neni 26). Në **PDESK** më tutje zgjerohen dispozitat mbi të drejtën për arsim, krahas

përsëritjes së pjesëve të saj; thekson nevojën për zhvillimit të rrjetit të shkollimit në të tri nivelet, përfshirë shkollat teknike dhe vokacionale të nivelit të mesëm, krijimin e bursave dhe përmirësimin e pozitës materiale të personelit arsimor (nenet 13-14).

Nga të drejtat tjera kulturore, e rëndësishme është **e drejta për pjesëmarrje në jetën kulturore**. Kjo e drejtë garantohet me akte ndërkombëtare për secilin individ (neni 27 i DUDNJ-së; neni 15 i PDESK-së). Kultura është nocion i gjerë që përfshinë krijimtarinë shoqërore: shkencore, letrare, artistike dhe kështu me radhë, si dhe krijimtarinë e gjeneratave të kaluara, atë që quhet trashëgimi kulturore. E drejta për pjesëmarrje në jetën kulturore është e drejtë për plotësimin e nevojave për kulturë të një individi, por edhe të drejtën për krijimtari kulturore që futen në formatit global kulturor, në kulturën botërore ose në formatin e veçantë të një regjioni, populli, bashkësie, gjë që krijon multikulturalitetin. Në të drejta kulturore bëjnë pjesë edhe **liria e hulumtimit shkencor**, **e drejta e shfrytëzimit të të arriturave shkencore**, si dhe **e drejta e mbrojtjes së të drejtave të krijuesve të veprave shkencore dhe artistike** (neni 17 i DUDNJ-së; neni 15 i PDESK-së).

6.4. Detyrimet e qytetarit

Krahas ekzistimit të lirive dhe të drejtave të njeriut ekzistojnë edhe detyrat e qytetarëve. E drejta e një personi, në të njëjtën kohë nënkupton të drejtën e tjerëve për të respektuar atë. Detyrat kushtetuese, megjithatë, nuk janë vetëpërmbajtje nga veprimi me qëllim të realizimit të lirive dhe të drejtave të dikujt, por mund të konsistojnë edhe në detyrimin për ndërmarrje të ndonjë veprimi. Detyrat kushtetuese nuk janë të shumta, siç janë liritë dhe të drejtat e njeriut. Zakonisht kushtetutat i ngërthejnë vetëm disa prej detyrimeve më kryesore. Të tjerat detyra gjenden në ligje. Detyrat kushtetuese më pastaj normohen më imtësisht me ligje: pa norma ligjore, ato nuk mund të realizohen (ekzekutohen) dhe, në rast të mospërmbushjes (mosekzekutimit), nuk mund të sanksionohen.

Moszbatimi i një detyrimi konkret ka për pasojë sanksionin, i cili duhet të jetë i përcaktuar me ligj. Sanksioni mund të jetë penal, ta zëmë, detyrimi për të respektuar lirinë dhe integritetin fizik dhe psikik të të tjerëve, detyrimi për respektim të barazisë para ligjit dhe kështu me radhë. Ai mund të jetë civilo-juridik, ta zëmë, konfiskimi i pasurisë për shkak të mospagimit të tatimit dhe kështu me radhë.

Detyrimi i parë, themelor, i qytetarit dhe, në të njëjtën kohë, edhe detyrim i organeve shtetërore dhe personave juridikë, konsiston në detyrimin për respektim të kushtetutës dhe ligjit. Ky detyrim nënkuptohet, që do të thotë se nuk ka nevojë të vihet në spikamë në mënyrë të posaçme në kushtetutë dhe në aktet të tjera juridike. Detyrimi i përgjithshëm që është parakusht për ekzistimin dhe realizimin e sistemit të lirive dhe të drejtave të njeriut është respektimi i lirive dhe të drejtave të tjerëve.

Detyrat konkrete të qytetarëve që zakonisht figurojnë në kushtetuta janë ato që mbrojnë vlerat themelore shoqërore. Kështu, ta zëmë, detyrimi kushtetues për mbrojtjen e shtetit është në shërbim të mbrojtjes së lirisë së qytetarëve. Këtë detyrim e kanë njerëzit e moshës madhore, kryesisht burrat. Në disa vende kjo detyrë është e përgjithshme dhe përfshinë edhe gratë (Izraeli). Detyrimi i pagimit të tatimit është i domosdoshëm për funksionim të shtetit. Kjo detyrë për pagim në të hyrat publike është e përgjithshme: tatimi zakonisht lidhet proporcionalisht me pasurinë dhe të ardhurat e detyruesit tatimor. Kjo nënkupton se ata që janë ekonomikisht më të fortë, të kamurit apo kamnorët, paguajnë më shumë në kuptim të shumës absolute apo sipas shkallës së caktuar të tatimit.

Detyrimi për ruajtjen e sekretit shtetëror, ushtarak apo zyrtar, përfaqëson ndalimin e dhënies apo bartjes në publik apo te të tjerët e të dhënave të besueshme që janë caktuar si sekret shtetëror, ushtarak ose zyrtar. Kjo detyrë i përket krejt atyre që vijnë në situatë për të disponuar me të dhëna të tilla.

Detyrimi i përkujdesjes ndaj të mirave publike dhe mbrojtja e tyre, ruajtja e përmendoreve kulturore dhe historike, mbrojtja e pasurive dhe trashëgimisë kulturore, mbrojtja e ambientit të shëndoshë jetësor përbëjnë detyrime që janë të vëna në interes të përgjithshëm. Ata që ushtrojnë funksione publike, funskionarët në organet e pushtetit, institucione, ndërmarrje publike, e kanë për detyrim që këtë ushtrim ta bëjnë në mënyrë të ndërgjegjshme. Brenda marrëdhënieve familjare, në kushtetuta përcaktohet detyrimi i prindërve për mbajtjen dhe përkujdesjen ndaj fëmijëve, kurse fëmijët e rritur të kujdesen për prindërit (në disa nga vendet e **Botës së Tretë** në **Amerikën Latine**).

Si një detyrim i posaçëm kushtetues mund të jetë njohja e gjuhës zyrtare të shtetit (gjuha spanjolle kastiliane në Spanjë) ose detyrimi për të dalë në zgjedhje (Australia, Turqia dhe disa vende).

6.5. Të drejtat e të huajve dhe e drejta për shtetësi

Të huaj konsiderohen personat që kanë shtetësinë e një shteti tjetër, jo shtetësinë e vendit ku gjenden, si dhe personat pa shtetësi. Pikënisja për caktimin e të drejtave të të huajve është se ata gëzojnë të gjitha liritë dhe të drejtat, përveç atyre që iu garantohen shtetasve të vendit. Ato të drejta që u garantohen vetëm shtetasve të vendit janë **të drejta politike**. Ushtrimi i pushtetit dhe në përgjithësi aktiviteti politik rezervohet për shtetasit, të cilët, këtë pushtet dhe aktivitet politik, bazuar në lidhjen juridiko-publike që kanë me shtetin, mund ta ushtrojnë vetëm në shtetin e tyre.

Të huajt nën disa kushte mund të kenë të drejta zgjedhore. Kjo e drejtë mund të fitohet për zgjedhjet lokale në njësinë e vetëqeverisjes lokale në të cilën i huaji ka vendqëndrimin, për shkak se i huaji që jeton në një qytet ka interes dhe nevojë të njëjtë në pushtetin lokal si edhe shtetasit e vendit. Për të realizuar të drejtat zgjedhore, i huaji duhet të ketë jetuar një kohë të caktuar në shtetin ku synon të realizoj këto të drejta, përkatësisht në njësinë e vetëqeverisjes lokale.

Të huajve mund t'u kufizohet edhe e drejta e pronësisë në patundshmëri. Ka raste kur kjo e drejtë është tërësisht e rezervuar për shtetasit e vendit, sa i përket disa llojeve të pronësisë, si p.sh., pronësia mbi tokën bujqësore.

Të huajt kanë një të drejtë që vetëm atyre iu garantohet – **e drejta e azilit** (strehimit). Azil mund të fitojnë në një shtet vetëm personat e përndjekur apo ata që kanë rrezik të përndjekjes në shtetin e vet për shkak të qëndrimeve politike, përkatësisë nacionale, fetare, racore apo të përkatësisë tjetër. Përmes të drejtës për azil, i huaji fiton të drejtën për të qëndruar në shtetin që ia ka njohur azilin.

Të huajt nuk barazohen me shtetasit e vendit as sa i përket detyrimeve kushtetuese. Detyrimi për mbrojtjen e shtetit i referohet vetëm shtetasve të vendit. Nën kushte të caktuara, të huajt, si jorezidentë, mund të lirohen nga pagimi i tatimit dhe kontributeve të tjera. Ndaj të huajve mund të zbatohet masa e dëbimit (deportimit) nga vendi, nëse plotësohen kushtet që lidhen me qëndrimin ilegal në një vend, për arsye të marrjes me aktivitet ilegale, gjithnjë duke u bazuar në një vendim gjyqësor. Dëbimi apo depërtimi i të huajit nuk guxon të ndodh në një vend ku i kanoset rreziku.

Shtetësia është lidhja juridiko-publike mes individit dhe shtetit. E drejta për shtetësi vërteton përkatësinë e individit ndaj shtetit dhe anasjelltas – shtetit ndaj individit. Për këtë arsye, me rastin e fitimit e shtetësisë, shpeshherë kërkohet që fituesi i saj, shtetasi i ardhshëm, të bëjë deklaratë solemne se shtetin e ri e njeh (konsideron) si të vetin.

Shteti gjithherë ka më shumë shtetas, kurse individët i përkasin më së shpeshti vetëm një shteti, më rrallë dy (**bipatridët**) e më shumë shteteve (**polipatridët**). Shtetësia e dyfishtë zakonisht fitohet në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare mes dy shteteve, por mund të jetë edhe rezultat i rrethanave faktike të krijuara si pasojë e shpërbërjes së shteteve apo rrethanave të tjera jetësore që fitojnë legjiti-

mitet juridik. Shtetësia është kusht për gëzimin e të gjitha lirive dhe të drejtave në shtet, përveç atyre, të cilat, për shkak të natyrës, u takojnë vetëm të huajve – e drejta për azil, e drejta e fitimit të shtetësisë, e drejta e koncesionit për të huajt. Shtetasit gëzojnë liri dhe të drejta edhe jashtë shtetit, ta zëmë, kujdesi dhe mbrojtja e shtetasve që jetojnë në botën e jashtme. Shtetasit kanë të gjitha detyrat e përcaktuara me kushtetutë dhe ligj, nisur nga e drejta për pagimin e tatimit e deri të detyrimi për mbrojtje të shtetit.

Shtetësia fitohet sipas afërsisë së gjakut (**ius sangunius**) – fëmija fiton shtetësinë e prindërve; sipas parimit territorial **(ius soli**) – fëmija fiton shtetësinë me lindje në territorin e shtetit; dhe, së treti, sipas natyralizimit – pranimi në shtetësi në bazë të vendbanimit (**ius domicili**) dhe plotësimit të kushteve për fitim të shtetësisë të vëna në kushtetutë dhe ligj. Shtetësia mund të pushoj (ndërpritet) me kërkesë të shtetasit, heqjen dorë nga shtetësia, braktisjen (lënien) e shtetësisë dhe, në disa raste, shtetësia mund të merret.

Në marrëveshje e traktate ndërkombëtare garantohet e drejta për shtetësi. Sipas **DUDNJ-së** çdo kush ka të drejtë për shtetësi dhe askush nuk mund të privohet nga shtetësia në mënyrë arbitrare, as nga e drejta për të ndryshuar shtetësinë (neni 15). Në **PDCP** garantohet e drejta e fëmijës për të pasur një shtetësi të caktuar (neni 24). Kushtetutat garantojnë të drejtën për shtetësi, në mesin e lirive dhe të drejtave njerëzore, por vetëm në nivel parimor apo të përgjithshëm (në dispozitat themelore kushtetuese zakonisht përcaktohet se shteti mbron të drejtat dhe interesat e shtetasve të vet, kurse të huajve u bëhet me dije se nuk kanë ato liri e të drejta që i kanë shtetasit e vendit), kurse kushtet e fitimit dhe ndërprerjes së shtetësisë rregullohen me ligj në mënyrë të detajuar.

6.6. Të drejtat dhe liritë e posaçme të minoriteteve nacionale

Me paraqitjen e kushtetutave të para të shkruara në truallin evropian (fundi shek. XVIII dhe shek. XIX) u krijuan shtetet nacionale. Në fillim kombet e mëdha, pastaj edhe kombet e vogla (Franca, Gjermania, Italia, Holanda, vendet ballkanike) krijojnë shtetet e tyre moderne, në të cilat synojnë të përfshijnë krejt anëtarët e kombit të njëjtë. As atëherë e as sot, një gjë e tillë nuk nënkupton se brenda shtetit jetojnë vetëm anëtarët e një kombi. Brenda shteteve bashkëkohore jetojnë edhe të tjerët, që përfaqësojnë pakica etnike, fetare, gjuhësore dhe pakica të tjera në raport me kombin shtetformues. Edhe para formimit të shteteve kushtetuese, popullsia e hapësirave të tyre ka qenë e ndarë në baza religjioze, gjë që ka çuar në përndjekjen e pakicave fetare dhe shkatërrimin e tyre gjatë luftërave të ndryshme (konfliktet e katolikëve, protestantëve, ortodoksëve dhe islamistëve). Pas diversitetit fetar, përgjatë shek. XX pranohet ekzistenca edhe e diversitetit etnik me të gjitha specifikat që posedon. Pikë kthese për këtë përfaqëson Lufta e Parë Botërore, përfundimi i së cilës krijoji një sistem për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të pakicave kombëtare, i njohur si **Sistemi i Versajës për Mbrojtjen e Pakicave.** Njohja e identitetit të posaçëm dhe specifik të pakicave kombëtare nga fillimi u bë me anë të marrëveshjeve të paqes, që u lidhën në kuadër të Konferencës së Paqes në Versajë (1919-1920), që shpjegon edhe vetë emrin e sistemit për mbrojtjen e pakicave që u krijua në Versajë. Kjo nuk do të thotë se në shekullin pararendës nuk ka pasur marrëveshje ndërkombëtare që normonin rolin dhe pozitën e pakicave kombëtare: ato kanë ekzistuar dhe lidhen posaçërisht me kongreset dhe konferencat ndërkombëtare të shek. XIX, siç janë, bie fjala, kongreset e Vjenës (1814-1815), Parisit (1856), Berlinit (1878) etj. Vetëm pas **Luftës së Dytë Botërore**, megjithatë, vjen deri te krijimi i një sistemi evropian për mbrojtjen e pakicave kombëtare. Kjo ndodhi sepse me shkatërrimin e tri perandorive të mëdha të kohës, austro-hungareze, gjermane, ruse dhe otomane, shtetet e reja që u krijuan në gërmadhat e tyre, ish-Jugosllavia, Çekosllovakia dhe Polonia, ishin po aq multietnike sa edhe vetë perandoritë e shkatërruara. Ky normim juridik-ndërkombëtar nuk u reflektua sa duhet dhe si duhet në kushtetutat nacionale të vendeve që u krijuan pas **Luftës së Parë Botërore**. Kjo shihet në mënyrën më brutale në rastin Shtetit ish-jugosllav, në të cilin, asnjëra prej kushtetutave të tij në mes të dy luftërave botërore, nuk njihte ekzistencën e pavarur të pakicave hungareze, shqiptare, malazeze, maqedone, sllovake dhe pakicave të tjera që **de facto** ekzistonin në atë shtet.

Pakicën kombëtare e përbëjnë pjesëtarët e bashkësisë etnike, të cilët, për nga raca, feja, gjuha, trashëgimia kulturore, përkatësisht sipas ndonjërit prej këtyre cilësive dallojnë nga populli shumicë në shtet. Anëtarët e pakicës kombëtare lidhen me ndjenjën e afërsisë, lidhshmërisë, dëshirën për ruajtjen e individualitetit vetjak dhe të dallimeve ekzistuese kundrejt popujve të tjerë që në të vërtetë përfaqëson anën subjektive të definicionit të pakicave kombëtare. Këto cilësi, në fakt, përfaqësojnë elementin subjektiv të kuptimit të pakicave kombëtare.

Shteti ia njeh statusin juridik-kushtetues të pakicës kombëtare bashkësisë së caktuar dhe në bazë të kësaj caktohet të drejta të posaçme që gëzojnë individët, si pjesëtarë të pakicës kombëtare, dhe vetë kolektiviteti si tërësi. Pjesëtarët e pakicave kombëtare janë shtetas të shtetit në të cilin jetojnë dhe, mbi këtë bazë, gëzojnë të gjitha liritë dhe të drejtat që kanë qytetarët tjerë. Krahas këtyre, me qëllim të ruajtjes së veçantive dhe arritjes së barazisë në mes të gjithë qytetarëve, pjesëtarëve të pakicave kombëtare u garantohen të drejta të veçanta (**diskriminimi pozitiv**) dhe ndërmerren masa të posaçme (**veprimi afirmativ**), me të cilat përmirësohet pozita e tyre e përgjithshme në shoqëri.

DUDNJ-ja nuk garanton të drejtat e pakicave kombëtare dhe pakicave të tjera. Këtë e bën PDCP-ja në nenin e vet 27. Arsyeja pse Deklarata nuk garanton të drejtat e pakicave lidhen me gjendjen e përgjithshme pas Luftës së Dytë Botërore dhe nevojën për arritjen e një konsensusi për miratim të një dokumenti gjithëpërfshirës për liritë dhe të drejtat e njeriut, në një ambient tërësisht të kontaminuar nga mbrojtja e të drejtave të pakicave nga regjimi nazist. Pikërisht për shkak se **Hitleri** (Adolf Hitler: 1889-1945) kishte kompromet uar të drejtat e pakicave, duke ndërhyrë në vendet tjera sovrane për gjoja mbrojtjen e pakicës gjermane, rasti i **Çekosllovakisë** duke qenë shembulli më drastik (**Marrëveshja e Munihut** e vitit 1938, që prishi pavarësinë dhe sovranitetin territorial dhe politik të këtij vendi), ka bërë që fokusi i **DUDNJ-së** dhe i krejt akterëve kryesorë të botës së asaj kohe të jetë në të drejtat dhe liritë individuale. As PDCP-ja nuk ka bërë ndonjë progres të madh në drejtim të mbrojtjen se lirive dhe të drejtave të njeriut, meqë akoma ishte e freskët kujtesa e krijuar nga"mbrojtja hitleriane e të drejtave të pakicave". Kjo shpjegon pse **PDCP-ja**, përkundër që paraqet progres në raport më Deklaratën, nuk përcakton detyrim për shtetet që të garantojnë liri dhe të drejta të posaçme për pakicat kombëtare, me qëllim të ruajtjes së veçantisë së tyre dhe arritjes së barazisë me të tjerët, por vetëm ndalon shkurtimin e disa prej të drejtave. Anëtarët e pakicave etnike, fetare apo gjuhësore nuk mund të privohen nga e drejta për të pasur jetë të veçantë kulturore, të shfaqin fenë e tyre dhe të përdorin gjuhën e vet. Këtu, pra, bëhet fjalë për të drejta personale dhe kulturore, në ndërkohë që nuk përmenden të drejta të posaçme politike. Liritë dhe të drejtat e pakicave proklamohen në mënyrë gjithëpërfshirëse për herë të parë, pa qenë të detyrueshme juridikisht, por që përfshijnë edhe të drejta e liritë politike, në **Deklaratën e OKB-së për të drejtat e pakicave etnike, fetare ose gjuhësore** (1992). Sipas këtij dokumenti, pjesëtarëve të pakicave iu njihen të drejta të posaçme politike – e drejta për pjesëmarrje efektive në vendimmarrje qendrore dhe regjionale (neni 2). Shtete detyrohen të ndërmarrin masa, në mënyrë që anëtarët e pakicave të gëzojnë të gjitha liritë dhe të drejtat, me qëllim të zhvillimit të kulturës, traditës, përdorimit të gjuhës, pjesëmarrjes në përparimin ekonomik. Pakicat, përveç kësaj, tani fitojnë të drejtën që për këto çështje të bashkëpunojnë me shtetet tjera (nenet 4-7). Në nivel evropian, dokumenti më i rëndësishëm për pakicat është **Konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare** (Këshilli i Evropës, 1995). Me këtë dokument në mënyrë të detajuar rregullohen liritë dhe të drejtat e anëtarëve të pakicave kombëtare, përjashtohet diskriminimi dhe garantohen në mënyrë të posaçme të drejtat politike – liria e tubimit dhe asociimit, liria e shprehjes; pastaj nxitet, në mes tjerash, pjesëmarrja e anëtarëve të pakicave kombëtare në jetën politike. Pjesëtarët e pakicave kombëtare, gjithashtu kanë detyrim për të respektuar ligjet e shtetit dhe të drejtat e qytetarëve të tjerë (nenet 4, 7 dhe 20).

Në planin e brendshëm, liritë dhe të drejtat e pakicave kombëtare garantohen me kushtetutë dhe ligje – ligjet mbi të drejtat e pakicave kombëtare dhe pakicave të tjera, ligji mbi arsimin, ligji mbi përdorimin e gjuhës dhe shkrimeve etj. Ekzistojnë kushtetuta në disa vende demokratike, që fare nuk njohin kategorinë e pakicave kombëtare (SHBA, Franca, Gjermania), as shteti nuk ndërmerr masa të posaçme për ruajtjen e veçantive të tyre.

Shtetet që njohin të drejta të posaçme për pakicat, nisen nga realiteti i ekzistimit të veçorive etnike, fetare ose gjuhësore të grupeve të caktuara të njerëzve. Ato grupe gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë e garantuara me kushtetutë, si dhe **të drejta të posaçme shtesë**. Të drejtat shtesë ndihmojnë që pjesëtarët e pakicave nacionale të gëzojnë **autonominë kulturore**, do të thotë të drejtën për përdorim të gjuhës së tyre për nevoja të arsimimit dhe zhvillimit të institucioneve sportive dhe kulturore, për zhvillim të programit të vet informativ dhe kështu me radhë. Në rastet kur pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtë në ndonjë formë të vetëqeverisjes politike, atëherë bëhet fjalë për **autonomi territoriale**. Niveli më i lartë i pavarësisë politike të pakicave zhvillohet në ato federatat ku njësitë federale formohen pikërisht për shkak të përbërjes nacionale.

Liritë dhe të drejtat e pakicave nëpër kushtetuta janë për sa vijon: e drejta për barazi nacionale dhe barazi tjetër, ndalimi i diskriminimit për shkak të përkatësisë nacionale dhe përkatësisë tjetër, liria e shprehjes së përkatësisë nacionale dhe përkatësisë tjetër, përdorimi i gjuhës dhe shkrimit amtar, zhvillimi i kulturës dhe ruajtja e traditës së pakicave kombëtare dhe pakicave të tjera (këtu hyn në veçanti themelimi i institucioneve arsimore, kulturore, informative dhe institucioneve të tjera, bashkëpunimi me bashkëkombësit në shtetet amë dhe me shtetet tjera). Aty ku garantohet e drejta në përfaqësim politik në organet e pushtetit, ajo konsiston në të drejtën e themelimit të partive politike, zakonisht nën kushte juridikisht më të lehta, garantimi i vendeve në parlament, fitimi më i lehtë i mandateve përmes pragut më të ulët apo pjesëmarrjes, përfaqësimi proporcional në organet e administratës dhe organet tjera.

7. Liritë dhe të drejtat njerëzore dhe të minoriteteve në Kushtetutën e Kosovës dhe në kushtetutat e vendeve përreth saj

Liritë dhe të drejtat njerëzore dhe të minoriteteve në Kosovë dhe vendet përreth saj shpërfaqin një ngjashmëri të madhe mes veti në aspektin formalo-juridik. Dallimet që ekzistojnë i takojnë sferës socio-politike, në të cilën vjen deri te implementimi i normave juridiko-kushtetuese mbi liritë dhe të drejtat e njeriut.

Ajo që dallon Kosovën nga vendet përreth, ndërkaq, ka të bëjë me faktin se vendi akoma nuk është anëtar i Këshillit të Evropës dhe OKB-së, përkundër që në nenin 22 të Kushtetutës së Kosovës (**KKos**) janë të listuara marrëveshjet dhe instrumentet kryesore regjionale dhe ndërkombëtare mbi liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve. Ky konstitucionalizim i normave dhe parimeve kryesore për të drejtat dhe liritë e njeriut, megjithatë, nuk ofron asnjë garancion për qytetarët e Kosovës se standardet e njëjta ndërkombëtare dhe regjionale zbatohen ndaj tyre nga ana e autoriteteve publike në Kosovë. Kjo është kështu sot për sot (maj 2022).

Në aspektet tjera formalo-juridike, sikundër u tha, konceptualisht nuk ka ndonjë ndryshim mes vendeve përreth Kosovës: secila prej tyre ka konstitucionalizuar, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, normat dhe parimet kyçe mbi liritë dhe të drejtat e njeriut. Dallimet që ekzistojnë, me përjashtim të **Kosovës**, kanë natyrë krejtësisht formalo-juridike, përkatësisht janë dallime që bazohen në mënyrën e **internalizimit** të normave dhe parimeve juridike, regjionale dhe ndërkombëtare, mbi liritë dhe të drejtat e njeriut si dhe bazuar në caqet e këtij **internalizimi**. Kjo nënkupton që **Kosova** edhe në aspektin formal dallon nga vendet përreth, sepse, siç u tha, me nenin 22 të Kushtetutës i ka shndërruar në norma kushtetuese disa prej marrëveshjeve dhe instrumenteve kryesore juridike, regjionale dhe ndërkombëtare, mbi liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve. Përveç kësaj, në Kosovë mungojnë një sërë lirish dhe të drejtash që përbëjnë standard normal kushtetues në çdo demokraci kushtetuese të proveniencës liberale. Këto lëshime i vëmë në dukje gjatë diskutimit tonë për liritë dhe të drejtat konkrete të njeriut, në vijim të këtij seksioni, në mënyrë që vetë lexuesi të gjykojë për këto lëshime mjaft serioze të kushtetutëbërësit kosovar. Fakti që neni 22 i **KKos** i kthen në norma kushtetuese tekstet kryesore juridike të së drejtës ndërkombëtare mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, megjithatë, nuk

lë hapësirë për ndonjë zbrastirë juridike: efektivisht nuk ka asnjë liri ose e drejtë që garantohet me marrëveshjet e instrumentet ndërkombëtare nga neni 22 si më sipër, që nuk shërben si burim juridik i të drejtës kushtetuese në Kosovë. Të shohim si duket krejt kjo.

7.1. Kushtet e realizimit të lirive dhe të drejtave njerëzore në Kosovë

Lidhur me realizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, në **KKos** bie në dukje mbështetja e fuqishme në burime të së drejtës ndërkombëtare, kurse sa i përket interpretimit të tyre mbështetja në praktikën dhe standardet ndërkombëtare, në veçanti në standardet dhe praktikën e GJEDNJ-së (neni 53). Mbrojtja e tyre ndërkombëtare, ndërkaq, është shumë e kufizuar për shkak të mosqenies shtet anëtar i Këshillit të Evropës (KE) dhe i OKB-së, brenda të cilave ekzistojnë mekanizmat relevantë ndërkombëtarë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave njerëzore, përfshirë të drejtat e posaçme shtesë të minoriteteve (KKos përdorë shprehjen komunitete, jo pakica, të cilat, megjithatë, mund të jenë komunitete pakicë dhe komunitetet shumicë, në vartësi të këndshikimit). Dispozitat mbi garancitë e lirive dhe të drejtave të njeriut, kufizimin e tyre, si dhe një numër i madh i lirive dhe të drejtave konkrete nga marrëveshjet dhe instrumentet e ndryshme ndërkombëtare kanë gjetur vend në **KKos**. Me dyfishimin e garancive mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, kushtetutëbërësi kosovar ka dashur të tregoj rëndësinë dhe peshën që ka kjo materie, por, në të njëjtën kohë, ka krijuar konfuzion për shkak se burime të ndryshme mbi liritë dhe të drejtat e njeriut përmbajnë dispozita të njëjta juridike.

DUDNJ, **PDCP**, **KEDNJ**, Konventa kornizë për minoritetet, Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, Konventa për diskriminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas, Konventa për të drejtat e fëmijës dhe Konventa kundër torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese, të gjitha këto sanksionohen me KKos, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike (neni 22). Kjo do të thotë se për zbatimin e tyre nuk ka nevojë të përpunohen më tutje më ndonjë akt juridik të brendshëm, u muar vesh, përveç rasteve kur ato nuk kanë natyrë të vetëzbatueshme. Në këtë kuptim, për to vlen rregulli i njëjtë si për marrëveshjet dhe traktatet ndërkombëtare që Kosova lidh me vendet e organizatat tjera sipas nenit 19.1 të **KKos.** I vetmi dallim është që, në rastin e marrëveshjeve dhe instrumenteve nga neni 22 bëhet fjalë për norma kushtetuese, kurse në rastin e atyre nga neni 19.1 bëhet fjalë për dispozita që kanë fuqinë e ligjit të Kosovës me forcë më të lartë juridike, përveç **KKos**.

Dispozitat kushtetuese kosovare mbi liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të komuniteteve interpretohen në pajtim me standardet ndërkombëtare ekzistuese mbi liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve dhe praktikën ndërkombëtare. Ky detyrim kushtetues buron nga neni 16.1 i KKos, që thotë se Kosova respekton të drejtën ndërkombëtare, në veçanti normat e saj juridikisht të detyrueshme (posaçërisht zakonet ndërkombëtare dhe traktate e ratifikuara), dhe nenet 22 dhe 53 të KKos. Neni 22, siç u pa, i internalizon një sërë traktatesh e instrumentesh ndërkombëtare, kurse neni 53 vë detyrim kushtetues për të gjitha autoritetet publike në Kosovë që liritë dhe të drejtat kushtetuese të interpretojnë në harmoni me vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së. Në themel të kësaj baze ndërkombëtare të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve, në Kosovë nuk figuron e drejta për të pasur qasje në mekanizma ndërkombëtarë për mbrojtjen e tyre, si pasojë e faktit që Kosova akoma nuk është shtet anëtar i KE-së dhe OKB-së, siç u konstatua më sipër. Ky përbën një hendikep, sepse qytetarët e vendit nuk kanë qasje në këto mekanizma për të ditur nëse shteti i tyre, Republika e Kosovës, është vërtetë duke interpretuar liritë dhe të drejtat e tyre kushtetuese sipas standardeve më të mira ndërkombëtare dhe evropiane.

Mbi liritë dhe të drejtat e njeriut flitet fare në fillim, në preambulën e KKos, në të cilën përshkruhet zotimi i popullit të Kosovës, i dhënë në një mënyrë solemne, që Kosova të jetë atdhe i të gjithë qytetarëve të vet, shtet i qytetarëve të barabartë, i cili do të garantojë të drejtat e secilit qytetar, liritë qytetare dhe

barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit. Më pas, në dispozitat themelore të kapitullit të parë (nenet 1-20) të KKos shpalosen orientimet e përgjithshme kushtetuese të Kosovës si shtet, vlerat që do t'i mbrojë, llojin e shtetit dhe formën e qeverisjes që do ta ketë në të ardhmen. Pasi përkufizon shtetin e Kosovës si shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik, dhe i pandashëm" (neni 1 parag.1), KKos definon esencën e themeleve mbi të cilat qëndron forma e qeverisjes, duke konstatuar se bazohet në qytetarin, në liritë dhe të drejtat e tij (paragrafi 2 i nenit 1). E drejta e qytetarëve për të realizuar sovranitetin normohet me nenin e dytë në vijim, në të cilin bëhet e qartë se origjina e pushtetit nuk është hyjnore ose ideologjike, apo çfarëdo tjetër: Sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet, në pajtim me Kushtetutën, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, me referendum, si dhe në forma të tjera, në pajtim me dispozitat e saj (neni 2, parag.1). Shteti qytetar domosdo që përmban edhe detyrimin e tij për të mbrojtur qytetarët e vete jashtë vendit, që bëhet me nenin 15 të dispozitave themelore. Kjo mbrojtje është rrjedhojë e natyrshme e shtetësisë që rregullohet me nenin pararendës, nenin 14. Kjo fizionomi esencialisht qytetare e Republikës së Kosovës nuk mohon një cilësi tjetër të rëndësishme të stofit kulturor të shoqërisë – multietnicitetin, i cili reflektohet dhe proklamohet në paragrafin e parë të nenit 3 të Kushtetutës, që përshkruan Kosovën si një shoqëri shumetnike, që qeveriset mbi baza demokratike, me respektim të sundimit të ligjit dhe ndarjen e pushteteve. Këto postulate kushtetuese marrin kuptim të plotë kur normohet mënyra kushtetuese e ushtrimit të pushtetit, që bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuara ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre (paragrafi. 2 i nenit 2).[42] Barazia e gjuhës shqipe dhe gjuhës serbe dhe e shkrimeve të tyre, në nivel të Republikës së Kosovës, garantohet me nenin 5, parag.1 të Kushtetutës, kurse gjuhët tjera kanë cilësinë e gjuhëve zyrtare vetëm sipas përcaktimeve ligjore. Respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut, në nenin 7 shpallet si një vlerë kushtetuese, krahas vlerave të tjera mbi të cilat qëndron rendin kushtetues kosovar (liria, paqja, demokracia, barazia, sundimi ligjit, mosdiskriminim, e drejta e pronës, mbrojtja mjedisit, drejtësia sociale, pluralizmi, ndarja e pushtetit shtetëror dhe ekonomia e tregut).

Kapitujt dy dhe tre të Kushtetutës në tërësi i kushtohen lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve të Kosovës. U mor vesh, dispozitat e kësaj materie kushtetuese gjenden edhe në pjesët tjera të Kushtetutës, që kanë të bëjnë, ta zëmë, me rregullimin e pushtetit, Gjykatën Kushtetuese, rregullimin territorial, ndryshimin e Kushtetutës. Disa prej ligjeve që kanë rëndësi në materien e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve janë ligjet: ligjet që normojnë rolin dhe pozitën e komuniteteve të Kosovës, të nxjerra në vijim të operacionalizimit të dispozitave të nenit 81 të KKos, të cilat ligje nuk mund t'i nënshtrohen referendumit; ligji që normon rolin dhe pozitën e Avokatit të Popullit; ligjet që ndalojnë diskriminimin dhe ligjet e kodet tjera sektoriale që operacionalizojnë liritë dhe të drejtat e garantuara me kushtetutë.

Pikë nisëse për realizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve është ndalimi i diskriminimit (neni 24, parag. 2). Diskriminimi ekziston kur dikush vihen në pozitë të pabarabartë, me akt juridik, veprim ose mosveprim, me të cilat mohohet ose kufizohet një e drejtë ose liri njerëzore. Ndalimi

[42] Cf. edhe Neni 81 [Legjislacioni me Interes Vital] i Kushtetutës:
"1.Për miratimin, ndryshimin ose shfuqizimin e ligjeve në vijim, kërkohet vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit dhe të shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë në shumicë:
(1) ligjet të cilat ndryshojnë kufijtë e komunave, themelojnë ose shuajnë komuna, përkufizojnë shtrirjen e pushteteve të komunave dhe pjesëmarrjen e tyre në marrëdhëniet ndërkomunale dhe tejkufitare;
(2) ligjet të cilat zbatojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, me përjashtim të atyre të përcaktuara me Kushtetutë;
(3) ligjet për përdorimin e gjuhëve;
(4) ligjet për zgjedhjet lokale;
(5) Ligjet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe zonave të veçanta të mbrojtura;
(6) ligjet për liritë fetare ose për marrëveshjet me komunitetet fetare;
(7) ligjet për arsimin;
(8) ligjet për përdorimin e simboleve, përfshirë simbolet e komuniteteve dhe për festat publike.
2. Asnjëri nga ligjet me interes vital, nuk mund t'i nënshtrohet referendumit".

i diskriminimit është, në fakt, e drejta për barazi, të cilën KKos e garanton në mënyrë të posaçme: "Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdo kush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim" (neni 24, parag.1). Sikundër shihet kjo e drejtë ngërthen edhe të drejtën e të gjithëve për mbrojtje juridike para gjykatës dhe organeve të tjera shtetërore. Cilësitë për shkak të të cilave dikush vihet në pozitë të pabarabartë dhe, për pasojë, diskriminohet, janë për si vijon: raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, mendimet politike ose mendimet tjera, prejardhja kombëtare a shoqërore, lidhja me ndonjë komunitet, prona, gjendja ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindja, aftësia e kufizuar ose ndonjë status tjetër personal. Me qëllim të shmangies së diskriminimit dhe arritjes së barazisë së plotë për të gjithë, individëve dhe grupeve, shteti nxjerr rregulla të caktuara dhe ndërmerr veprime. Grupet që shteti i mbështet me qëllim të realizimit të barazisë së plotë janë anëtarët e komuniteteve pakicë, gratë në sferën e të drejtës zgjedhore, personat e rrezikuar shoqërisht dhe personat me invaliditet. Akoma nuk ekziston një rregullativë e qartë lidhur me personat që akoma diskriminohen për shkak të orientimit seksual dhe pikëpamjeve të tjera lidhur me jetën transgjinore, në veçanti sa i përket martesave dhe segmenteve të tjera të së drejtës familjare të kësaj kategorie të qytetarëve (komuniteti **LGBT** Plus). Në momentin e shkruarjes së këtyre rreshtave (maj 2022), akoma vazhdon debati lidhur me draftin e refuzuar nga Kuvendi javë më parë, dhe që pritet sërish në qershor të dal në rend të dite. Ky draft parashikonte liri dhe të drejta në sferën e familjes dhe martesës e bashkëjetesës së personave të këtij komuniteti. Nga redaktimi i dispozitës së nenit 24, parag. 2 të **KKos**, qartë shihet se si bazë për diskriminim është edhe orientimi seksual i individit.

Si pikënisje e dytë për realizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve është **e drejta për shtetësi** (neni 14). Shtetësia është e domosdoshme për të fituar statusin juridik, i cili mundëson realizimin e vëllimit kushtetues të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe detyrat kushtetuese.

E drejta për shtetësi nënkupton mbrojtje të veçantë kushtetuese. Shtetasit e Kosovës, për dallim nga shtetasit e huaj, nuk mund të dëbohen, që do të thotë se, Shteti atyre nuk mund t'ua mohoj banimin në territorin e tij. Shtetasit nuk mund t'i merret shtetësia, që dikur ka ekzistuar dhe njihet si "vdekja civile". Kjo do të thotë se kjo e drejtë është në rangun e të drejtave të natyrore, të patjetërsueshme e të pacenueshme, në kuptim të nenit 21 parag.1 të **KKos**. Gjithashtu, Shteti nuk mund të mbaj (pengoj) dikë nga ndryshimi i shtetësisë së Kosovës dhe, në vend të saj, të fitoj (merr) një shtetësi tjetër.

Vetë fakti që e drejta për shtetësi është një e drejtë e patjetërsueshme dhe pacenueshme nënkupton që ajo gëzon mbrojtje absolute dhe hyn në kategorinë e të drejtave absolute, përkundër që në nenin 56 KKos nuk listohet si e tillë. Kjo do të thotë se nga e drejta për shtetësi nuk mund të ketë shmangie në kohën e gjendjes së jashtëzakonshme dhe as që mund të kufizohet në çfarëdo mënyre. **Ligji nr. 04/L-215 për shtetësinë e Kosovës**, miratuar në vijim të implementimit të dispozitës së nenit 14 të KKos, rregullon në mënyrë të detajuar fitimin e shtetësisë (me lindje; me adoptim; me natyralizim; në bazë të marrëveshje ndërkombëtare; në bazë të neneve 31 dhe 32 të këtij ligji) dhe humbjen e shtetësisë (me lirim nga shtetësia; me privim të shtetësisë; dhe në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare me lënie, heqje dorë dhe sipas marrëveshjes ndërkombëtare).[43]

7.1.1. Kushtet e realizimit të lirive dhe të drejtave njerëzore në Shqipëri

Kushtet nën të cilat realizohen liritë dhe të drejtat e njeriut në Shqipëri, në thelb, nuk dallojnë nga kushtet dhe përcaktime kushtetuese në Kosovë, tanimë të diskutuara. Për dallim nga Kosova, megjithatë, në kapitullin e dytë të Kushtetutës së Shqipërisë (KShq), sa i përket interpretimit nuk bie në sy mbështetja në praktikën dhe standardet ndërkombëtare. Duke qenë Shqipëria anëtare e **KE-së** dhe, për pasojë, edhe **GJEDNJ-së**, qytetarët e saj kanë qasje në **Strasburg** për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të tyre të garantuara me Konventë. Kjo nënkupton se interpretimi i **KEDNJ-së** në sistemin juridik shqiptar

[43] Nenet 5 dhe 19 të *Ligjit nr. 04/L-215 për shtetësinë e Kosovës.* **Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës** nr. 33, 2 shtator 2013, Prishtinë.

i nënshtrohet rregullave dhe parimeve të njëjta si për çdo shtet tjetër anëtar të KE-së: vendimet e Strasburgut kanë efekt për shtetin shqiptar për aq sa ato kanë të bëjnë me Shqipërinë, kurse standardet që ndërtohen në Strasburg vlejnë për gjykatat shqiptare dhe për Gjykatën Kushtetuese për shkak të autoriteti të lartë moral dhe standardeve që kanë. Kjo është kështu për shkak se neni 4.2 i KShq përcakton se Kushtetuta është ligji më i lartë në vend, kurse më pas, në nenin 5 të saj thuhet se drejta ndërkombëtare në Shqipëri zbatohet për aq sa ajo është e detyrueshme. Këtë cilësi, pra cilësinë e të drejtës së detyrueshme, e drejta ndërkombëtare e fiton kur ekzistojnë marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara apo të lidhura sipas procedurës së përcaktuar me KKshq dhe ligje, situatë kjo tipike për shtetet e pavarura dhe sovrane.

Në KShq nuk ekziston një listë e marrëveshjeve ose dokumenteve ndërkombëtare që kanë karakter kushtetues dhe zbatohen drejtpërdrejtë si çdo normë kushtetuese në kuptim të nenit të saj 4.3. Shqipëria, megjithatë, përveç që është palë në KEDNJ, është palë dhe anëtarë në shumicën e marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare mbi liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve. Kjo reflektohet në dispozitat e kapitullit të dytë të KShq, i cili është më i ngjeshur dhe përfshinë të gjitha liritë dhe të drejtat nga KEDNJ-ja, thuajse me emër dhe përmbajtje identike,[44] për dallim nga Kosova ku, siç u pa, ekziston një diskrepancë në rregullim dhe një emërtim, përkatësisht një shpërputhje e normimit kosovar kushtetues me dispozitat e **KEDNJ-së** dhe instrumenteve e marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare të listuara në nenin 22 të KKos.

Në kapitullin e dytë, KShq bën ndarjen e lirive dhe të drejtave të njeriut sipas gjeneratave, dhe këtë ndarje e reflekton në titullin e secilës gjeneratë (nenet 21-58), duke lehtësuar dukshëm punën e atyre që duhet të zbatojnë KShq. I vetmi referim në KShq me pasojë ngritjen e KEDNJ-së në status të normës kushtetuese gjendet në nenin 17.2, që ka të bëjë me kufizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Aty thuhet se "këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut". Në literaturën shqiptare, kjo është cilësuar si zgjidhje unike e kushtetutëbërësit shqiptar, e bërë me synim të vetëm reduktimin e rasteve nga Shqipëria në **GJEDNJ**, përkatësisht për të disiplinuar ligjvënësin dhe gjyqësorin shqiptar, përfshirë Gjykatën Kushtetuese, ashtu që kur të nxjerrin ligj ose vendosin lidhur me liritë dhe të drejtat e njeriut të kenë parasyshë standardet e kufizimit të tyre të përcaktuara nga KEDNJ-ja dhe jurisprudenca e GJEDNJ-së.[45]

Liritë dhe të drejtat e njeriut përmenden në Preambulë, kurse respektimi i dinjitetit dhe personalitetit njerëzor ka karakterin e zotimit të kushtetutëbërësit shqiptar. Mëpastaj, pjesa operative e **KShq** nis me pavarësinë dhe sovranitetin, ku dinjitet i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij dhe drejtësia shoqërore dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e shtetit, kurse vetë Kushtetuta zbatohet drejtpërdrejt dhe ka epërsi mbi çdo akt tjetër juridik në vend (nenet 1-5).

Mbi liritë dhe të drejtat e njeriut flitet, sikundër u tha, flitet në preambulë. Në pjesën e dispozitave themelore operative, Shqipëria definohet si shtet i shqiptarëve: merret si e mirëqenë se Shqipëria është shtet i shqiptarëve, gjë që është në frymë edhe të preambulës, e cila aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar e merr si frymëzim të konstitucionalizmit shqiptar. Sovraniteti i takon popullit (neni 2.1), në një republikë parlamentare, në të cilën jeton shteti unitar dhe i pandashëm shqiptar (neni 1). Karakteri nacional i shtetit më tutje forcohet në dispozitat e nenit 8, që shërbejnë si pikënisja e parë e definimit të kushtetuese në të cilat realizohet kapitulli i dytë mbi liritë dhe të drejtat e njeriut. Në këtë nen gjenden tri premisa që formojnë sovranizimin e Shqipërisë përtej kufijve të saj politik. E para, Republika e Shqipërisë mbron të drejtat kombëtare të popullit shqiptar që jeton jashtë kufijve të saj (8.1). Premisa e dytë është se Republika e Shqipërisë mbron të drejtat e

[44] Luan Omari, Aurela Anastasi, *E drejta kushtetuese* ("Dajti 2000": Tiranë, 2017) fq. 78-79.
[45] Ibid., fq. 78-79.

shtetasve shqiptarë me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të vet (neni 8.2). Dhe, së fundi, premisa e tretë, Republika e Shqipërisë u siguron ndihmë shtetasve shqiptarë që jetojnë e punojnë jashtë shtetit për të ruajtur e për të zhvilluar lidhjet me trashëgiminë kulturore kombëtare (neni 8.3). Kjo do të thotë se, Shteti shqiptar kujdeset dhe mbron të drejtat e shqiptarëve që kanë shtetësi shqiptare dhe shqiptarët etnikë që nuk kanë shtetësi shqiptare dhe jetojnë nën juridiksionet e shteteve të tjera.

Kjo mbrojtje është rrjedhojë e natyrshme e shtetësisë që rregullohet me nenin 16.1 të Kushtetutës, që përcakton se "Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëlloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara". Shqipëria, për dallim nga Kosova, nuk definohet si **shoqëri multietnike**. Qeverisja, ndërkaq, bazohet në barazinë e të gjithëve para ligjit (nenet 1.3 dhe 18.1).

Njëjtë si në Kosovë, në KShq, mënyra e ushtrimit të pushtetit është ngritur mbi disa postulate kushtetuese, që lidhen me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushtetit (neni 7), barazinë para ligjit dhe msodiskriminimin (18) dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (neni 15.2). Nocioni i vlerave kushtetuese mbi të cilat mbështetet rendi juridik shqiptar, ndërkaq, është më i gjërë dhe përmblidhet në nenin 3, në të cilin thuhet si vijon: "Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë".

Kapitulli i dytë i **KShq** normon liritë dhe të drejtat e njeriut, përfshirë edhe formulimin mjaft ekspresiv për pakicat nga neni 3 ("mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat"), që u zu në gojë më sipër. U mor vesh, njëjtë si në Kosovë, dispozitat e kësaj materie kushtetuese gjenden edhe në pjesët tjera të KShq, që kanë të bëjnë, ta zëmë, me rregullimin e pushtetit, Gjykatën Kushtetuese, rregullimin territorial. Disa prej ligjeve që kanë rëndësi në materien e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve janë: ligjet që ndalojnë diskriminimin, marrëdhëniet civile, rolin dhe pozitën e Avokatit të Popullit, zgjedhjet, si dhe ligjet dhe kodet tjera sektoriale që operacionalizojnë liritë dhe të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

Edhe në Shqipëri, pikë nisëse për realizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut është **ndalimi i diskriminimit** (neni 18.2). Ndalimi i diskriminimit është, në fakt, e drejta për barazi, të cilën KShq e garanton në mënyrë të posaçme: "Të gjithë janë të barabartë para ligjit" (neni 18.1). Cilësitë për shkak të të cilave dikush vihet në pozitë të pabarabartë dhe, për pasojë, diskriminohet, janë për si vijon: gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore (neni 18.2). Lista e bazave për diskriminim, sikundër shihet, është shteruese dhe ndryshon nga rasti Kosovës. Në rastin e KKos, çdo bazë që dallon një person nga të tjerët, potencialisht mund të jetë bazë për diskriminim. Në Shqipëri, sikundër shihet, orientimi seksual nuk është bazë për diskriminim. Edhe Shteti shqiptar, me qëllim të shmangies së diskriminimit dhe arritjes së barazisë së plotë për të gjithë, individëve dhe grupeve, nxjerr rregulla të caktuara dhe ndërmerr veprime që kanë për synim ndreqjen e pabarazive dhe diskriminimit. Grupet që Shteti i mbështet me qëllim të realizimit të barazisë së plotë janë anëtarët e komuniteteve pakicë, gratë në sferën e të drejtës zgjedhore, personat e rrezikuar shoqërisht dhe personat me invaliditet. Akoma nuk ekziston një rregullativë e qartë lidhur me personat që diskriminohen për shkak të orientimit seksual dhe pikëmapjeve të tjera lidhur me jetën transgjinore, në veçanti sa i përket martesave dhe segmenteve të tjera të së drejtës familjare të kësaj kategorie të qytetarëve (komuniteti **LGBT** Plus). Në momentin e shkruarjes së këtyre rreshtave (maj 2022), edhe në Shqipëri vazhdon debati lidhur me liritë dhe të drejtat e këtij komuniteti.

Edhe në Shqipëri, si pikënisje e dytë për realizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve është **e drejta për shtetësi** (neni 16.1). Shtetësia është e domosdoshme për të fituar statusin juridik, i cili mundëson realizimin e vëllimit kushtetues të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe detyrat kushtetuese.

Ky është një përcaktim i qartë i nenit të sipërcekur 16.1, që thotë: "Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëlloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara". Sikundër shihet, pra, shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi nuk diskriminohen në asnjë mënyrë, për aq sa nuk bëhet fjalë për liri dhe të drejta që rezervohen për shtetasit shqiptarë.

E drejta për shtetësi nënkupton mbrojtje të veçantë kushtetuese, sic dihet. Shtetasit e Shqipërisë nuk mund të dëbohen, që do të thotë se atyre nuk mund t'iu mohohet banimi dhe qëndrimi në territorin e saj. Kjo gjithashtu nënkupton se shtetasit nuk mund t'i merret shtetësia dhe as nuk mund të pengohet që të heq dorë prej saj (neni 19.2 lidhur me nenin 39). Kjo do të thotë se kjo e drejtë është në rangun e të drejtave natyrore, të patjetërsueshme e të pacenueshme, njëjtë si në Kosovë. Vetë fakti që e drejta për shtetësi është një e drejtë e patjetërsueshme dhe pacenueshme nënkupton që ajo gëzon mbrojtje absolute dhe hyn në kategorinë e të drejtave absolute, përkundër që në nenin 19 nuk definohet si e tillë. Kjo do të thotë se nga e drejta për shtetësi nuk mund të ketë shmangie në kohën e gjendjes së jashtëzkonshme dhe as që mund të kufizohet në çfarëdo mënyre.

7.1.2. Kushtet e realizimit të lirive dhe të drejtave njerëzore në Maqedoninë e Veriut

Lidhur me realizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, në **Kushtetutën e Maqedonisë së Veriut** (KMVer) bie në sy mungesa e mbështetjes së fuqishme në burime të së drejtës ndërkombëtare, situatë e kundërt me Kosovën dhe deri dikund me Shqipërinë. Gjithashtu, sa i përket interpretimit të burimeve të së drejtës ndërkombëtare, në tërësi vlejnë rregullat e të drejtës së brendshme maqedonoveriore dhe nuk ekziston një detyrim për mbështetje në praktikën dhe standardet ndërkombëtare, në veçanti në standardet dhe praktikën e **GJEDNJ-së**. Kjo është kështu për tri arsye: e para, sepse në nenin 50 parag. 1 dhe 2 të KMVer thuhet se mbrojtja e lirive dhe të drejtave kushtetuese bëhet përmes procedurave gjyqësore dhe procedurave pranë Gjykatës Kushtetuese, të cilat mbështeten e parimet e prioritetit dhe urgjencës, si dhe garantohet kontrolli i ligjshmërisë së akteve individuale të administratës dhe institucioneve të tjera që ushtrojnë autorizime publike; e dyta, për shkak se sipas nenit 118 të KMVer, marrëveshjet e ratifikuara kanë fuqi më të lartë se çdo ligj dhe se KEDNJ-ja nuk ka asnjë pozitë apo status kushtetues të privilegjuar, siç ndodh me Kosovë dhe Shqipëri; dhe, së treti, sepse katalogu u lirive dhe të drejtave të njeriut në kapitullin e dytë të **KMVer** është shumë i ngjashëm me atë nga KEDNJ-ja dhe se, në kuadër të garancionit të lirive dhe të drejtave të njeriut nga neni i saj 50 parag. 3, qytetari ka të drejtë të njoftohet me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në mënyrë aktive të kontribuojë, individualisht ose bashkë me të tjerët, për përparimin dhe mbrojtjen e tyre.

Mbrojtja e tyre ndërkombëtare, ndërkaq, nuk përmendet në **KMVer** por, nisur nga fakti se vendi është anëtar i KE-së dhe i OKB-së, brenda të cilave ekzistojnë mekanizmat relevantë regjionalë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave njerëzore, përfshirë të drejtat e posaç*me shtesë të minoriteteve,* **Maqedonia e Veriut** ka një pozitë të volitshme dhe qytetarët e saj dhe të tjerët që bijnë nën juridiksionin e saj kanë qasje në këto forume. Këtu e kemi fjalën në veçanti për dispozitat mbi garancitë e lirive dhe të drejtave të njeriut, kufizimin e tyre si dhe listën e gjatë të lirive dhe të drejtave konkrete që kanë origjinë ndërkombëtare, por që kanë gjetur vend në **KVer**. Të tilla janë, ta zëmë: **DUDNJ**, **PDCP**, **KEDNJ**, Konventa kornizë, Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, Konventa për diskriminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas, Konventa për të drejtat e fëmijës dhe Konventa kundër torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese, krejt kjo për shkak se, përmes ratifikimit, këto janë bërë pjesë e sistemit juridik maqedonoverior dhe zbatohen drejtpërdrejtë dhe, në rast konflikti, kanë përparësi ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Kjo bëhet e qartë nga redaktimi i dispozitës së nenit 118 të Kushtetutës, që përcakton se marrëveshjet ndërkombëtare të cilat janë ratifikuar në përputhje me Kushtetutën janë pjesë e rendit juridik të brendshëm dhe nuk mund të ndryshohen me ligj. Kjo do të

thotë se për zbatimin e tyre nuk ka nevojë të përpunohen më tutje më ndonjë akt juridik të brendshëm, u muar vesh, përveç rasteve kur ato nuk kanë natyrë të vetëzbatueshme. Në këtë kuptim, për to vlen rregulli i njëjtë si për marrëveshjet dhe traktatet ndërkombëtare që lidh Kosova me vendet tjera dhe me organizatat ndërkombëtare sipas nenit 19.1 të KKos. I vetmi dallim është që, në rastin e marrëveshjeve dhe instrumenteve nga neni 22 i KKos, bëhet fjalë për norma kushtetuese, kurse në rastin e marrëveshjeve dhe instrumenteve nga neni 19.1 bëhet fjalë për akte juridike që përmbajnë norma të rangut të ligjeve të Kosovës me fuqinë më të lartë juridike në vend, me përjashtim të fuqisë që ka Kushtetuta.

Sa i përket interpretimit, në KMVer nuk ekziston ndonjë pikë referimi me forcë kushtetuese, përkatësisht nuk ekziston detyrimi kushtetues, si në Kosovë, që liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të komuniteteve të interpretohen në pajtim me standardet ndërkombëtare ekzistuese mbi liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve dhe praktikën ndërkombëtare. Ekzistojnë dy detyrime të përgjithshme kushtetuese, që burojnë nga 8 parag. 1 i KMVer, në të cilin sanksionohen vlerat themelore kushtetuese, ku bëjnë pjesë respektimi i normave përgjithësisht të pranuara të së drejtës ndërkombëtare (zakoni ndërkombëtar) dhe i lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe të qytetarit, të njohura me të drejtën ndërkombëtare dhe të përcaktuara me Kushtetutë. Kjo, megjithatë, nuk është e mjaftueshme, sepse ky detyrim gjendet në kapitullin mbi dispozitat themelore, jo në kapitullin mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, por edhe sepse e drejta ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, sipas kësaj dispozite, ka për bazë përcaktimin kushtetues, jo anasjelltas. Kjo na lejon të konkludojmë se, parimet themelore të interpretimit të lirive dhe të drejtave të njeriut duhen kërkuar jashtë tekstit kushtetues, në rend të parë në standardet që krijohen në GJEDNJ nga vendimet e karakterit **inter partes** (në të cilat **Maqedonia e Veriut** ka qenë palë ndërgjyqëse), pastaj vijnë standardet nga rekomandimet e Komitetit për të drejtat e njeriut dhe të trupave të tjerë kontraktual dhe jokontraktual, në të cilat **Maqedonia e Veriut** është palë apo anëtar dhe, në fund, vendimet e vetë Gjykatës Kushtetuese të marra sipas ankesës kushtetuese dhe në vazhdën e kontrollit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve juridike të autoriteteve publike në këtë vend.

Në themel të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve në Maqedoninë e Veriut është dimensioni ndërkombëtar i kësaj mbrojtjeje, si pasojë e faktit që vendi është shtet anëtar i KE-së dhe OKB-së, siç u konstatua më sipër. Kjo përbën një përparësi të madhe, në krahasim me Kosovën, sepse qytetarët maqedonoveriorë kanë qasje në mekanizmat regjionalë dhe ndërkombëtarë dhe, për pasojë, edhe mundësi për të ditur nëse shteti i tyre vërtetë interpreton liritë dhe të drejtat kushtetuese sipas standardeve ndërkombëtare dhe evropiane.

Mbi liritë dhe të drejtat e njeriut flitet fare në fillim, në preambulën e KMVer. Aty garantohen të drejtat e njeriut, liritë qytetare dhe barazia nacionale, krahas paraqitjes së shtetit si shtet nacional i popullit maqedonas, në të cilin sigurohet barazia e plotë qytetare dhe bashkëjetesa e përhershme e popullit maqedonas me shqiptarët, serbët, turqit, vllahët, romët, boshnjakët dhe popujt tjerë që jetojnë në të. Në preambulë, Shteti zotohet ka për qëllim sigurimin e paqes dhe bashkëjetesës së popullit maqedonoverior me kombësitë që jetojnë në Republikën e Maqedonisë Veriore.

Më pas, në dispozitat themelore të kapitullit të parë (nenet 1-8) shpalosen orientimet e përgjithshme kushtetuese të Maqedonisë së Veriut si shtet, vlerat që mbron, lloji i shtetit dhe forma e qeverisjes. Republika e Maqedonisë është shtet sovran, i pavarur, demokratik dhe social. (neni 1 parag. 1), kurse sovraniteti është i pandashëm, i patjetërsueshëm dhe i pambartshëm (neni 1 parag. 2) Për dallim nga Kosova, sovraniteti në Maqedoninë e Veriut i takon qytetarëve (neni 2 parag. 1). Esencën e themeleve mbi të cilat qëndron forma e qeverisjes gjendet në paragrafin e dytë të nenit 2 të KMVer, që thotë se qytetarët e realizojnë sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet referendumit dhe formave të tjera të deklarimit të drejtpërdrejtë. Edhe këtu, si në Kosovë dhe vendet tjera përreth, bëhet e qartë se origjina e pushtetit nuk është hyjnore, ideologjike apo çfarëdo tjetër: ai buron nga qytetarët dhe realizohet sipas formave saktësisht të përcaktuara me Kushtetutë. Dispozitat themelore këtu janë më të shkurtëra dhe më të përmbledhura se në KKos. I tillë është rasti

edhe me nenin 8, që sanksionon vlerat e rendit kushtetues, përveç atyre që u zunë në gojë më sipër, dhe të cilat konsistojnë në sa vijon:

- të shprehurit e lirë të përkatësisë kombëtare;
- sundimi i së drejtës;
- ndarja e pushtetit shtetëror në ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor;
- pluralizmi politik dhe zgjedhjet e lira, të drejtpërdrejta dhe demokratike;
- mbrojtja juridike e pronësisë;
- liria e tregut dhe e sipërmarrësisë;
- humanizmi, drejtësia sociale dhe solidariteti;
- vetadministrimi lokal; dhe
- rregullimi dhe humanizimi i hapësirës dhe mbrojtja dhe përparimi i mjedisit jetësor dhe i natyrës.

Një vend të rëndësishëm në dispozitat themelore zë edhe çështja e gjuhës zyrtare: përcaktimi i kushtetutëvënësin maqedonoverior në këtë drejtim ka ndryshuar që nga koha e fitimit të pavarësisë së vendit. Në fillim, neni 7 KMVer ka pasur një përcaktim shumë përjashtues ndaj diversitetit gjuhësor të shoqërisë: në paragrafin e parë të këtij neni përcaktohej qartë se në "Republikën e Maqedonisë gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik". Në paragrafin e dytë fillonte një zbutje e këtij qëndrimi përjashtues, duke përcaktuar se "në njësitë e vetadministrimit lokal, në të cilat si shumicë jetojnë pjesëtarët e kombësive, në përdorim zyrtar krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik, janë edhe gjuha dhe alfabeti i kombësive në mënyrë të përcaktuar me ligj". Zbutja nuk mungonte as në paragrafin e fundit të nenit në fjalë, që thoshte se "në njësitë e vetadministrimit lokal, në të cilat në numër të konsiderueshëm jetojnë pjesëtarët e kombësive, në përdorim zyrtar krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik, janë edhe gjuha dhe alfabeti i kombësive, në kushte dhe në mënyrë të përcaktuara me ligj". Me amendamentin V (2001) në **KMVer** është zëvendësuar ky nen, ashtu që tani gjuhë tjetër që e flasin së paku 20 % e qytetarëve, gjithashtu është gjuhë zyrtare si dhe alfabeti i saj, krahas gjuhës maqedone dhe alfabetit të saj cirilik, siç është përcaktuar me këtë amendament dhe me ligj. Më këtë amendament janë rregulluar edhe përdorimet e gjuhëve dhe alfabeteve të tjera veç asaj maqedone dhe alfabetit të saj cirilik, në nivele qendror dhe joqendror, komunikimi ndërinstitucional dhe lëshimi i dokumenteve personale të qytetarëve. Zgjidhjet kushtetuese të këtij amendamenti janë dukshëm më të përparuara se neni dikurshëm 7 i KMVer, sepse përafrojnë barazinë e gjuhëve dhe shkrimeve të tjera, në veçanti të gjuhës shqipe dhe shkrimit të saj, për shkak të përqindjes së lartë të popullsisë shqiptare në Maqedoninë e Veriut.

Republika e Maqedonisë si një shtet qytetar, domosdo që përmban edhe detyrimin për të mbrojtur qytetarët e vet që jetojnë jashtë vendit. Ky detyrim në fillim ka qenë shumë përjashtues dhe nuk ka respektuar diversitetin nacional, gjuhësor, etnik dhe tjetër të shtetasve të këtij vendi që ndodhen në botën e jashtme. Neni 49 i KMVer, në dy paragrafë, reflektonte këtë qasje përjashtuese dhe mononacionale. Në paragrafin e parë thoshte se "Republika kujdeset për pozitën dhe të drejtat e pjesëtarëve të popullit maqedonas në shtetet fqinje dhe për emigrantët nga Maqedonia, e ndihmon zhvillimin e tyre kulturor dhe i përparon lidhjet me ta", kurse në të dytin pohonte se "Republika kujdeset për të drejtat kulturore, ekonomike dhe sociale të qytetarëve të Republikës jashtë vendit". Me amendamentin XXXVI (2019) kjo gjendje ka ndryshuar ashtu që tani në mënyrë shumë specifike përmirësohet mbrojtja e shtetasve maqedonoveriorë që kanë stof etnik, fetar, kulturor dhe tjetër, të ndryshëm nga ai maqedon. Kjo sepse, kjo dispozitë kushtetuese në mënyrë shprehimore flet për shqiptarët, turqit, vllahët, serbët, romët, boshnjakët dhe të tjerët që kanë shtetësi maqedonoveriore.

Kapitulli i dytë i KMVer (nenet 9-54), në tërësi i kushtohet lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të qytetarit. Vetë titulli i këtij kapitulli është "Liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe të qytetarit": bëhet dallim në mes të lirive dhe të drejtave që iu takojnë individëve apo subjektëve të tjetër të së drejtës që

bien nën juridiksionin e këtij vendi dhe lirive dhe të drejtave të rezervuara për shtetasit e vendit. Kjo nuk është kështu në Kosovë. Njëjtë vlen edhe për klasifikimin kushtetuese të lirive dhe të drejtave të njeriut sipas gjeneratave, gjë e cila mungon në KKos. Njëjtë si në Kosovë, u mor vesh, dispozitat mbi liritë dhe të drejtat e njeriut dhe detyrat, gjenden të shkapërderdhura edhe në pjesët tjera të **KMVer**, siç janë ato që kanë të bëjnë, ta zëmë, me rregullimin e pushtetit, Gjykatën Kushtetuese, rregullimin territorial, ndryshimin e Kushtetutës, pastaj ligjet që ndalojnë diskriminimin, që rregullojnë organizimin dhe punën e organeve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera që ushtrojnë autorizime publike, kodet tjera sektoriale që operacionalizojnë liritë dhe të drejtat kushtetuese etj.

Edhe në **Maqedoninë e Veriut**, si pikë nisëse për realizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve është **ndalimi i diskriminimit**, ani pse një gjë e tillë nuk thuhet shprehimisht si në rastin e Kosovës. Sikundër u pa, në mesin e vlerave kushtetuese që mbron rendi juridik maqedonoverior janë liritë dhe të drejtat e njeriut, në ndërkohë që nën nenin 9 të Kushtetutës në mënyrë të qartë promovohet barazia e të gjithëve para Kushtetutës dhe ligjit, kurse qytetarët e vendit cilësohen si të barabartë në liritë dhe të drejtat pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, prejardhja kombëtare dhe sociale, bindja politike dhe fetare, pozita pronësore dhe shoqërore. Ky sanksionim i barazisë domosdo përshkon të gjitha liritë dhe të drejtat e njeriut, individuale dhe kolektive.

As në **Maqedoninë e Veriut** akoma nuk ekziston një rregullativë e qartë lidhur me personat që diskriminohen për shkak të orientimit seksual dhe pikëpamjeve të tjera lidhur me jetën transgjinore, në veçanti sa i përket martesave dhe aspekteve të tjera të së drejtës familjare të kësaj kategorie të qytetarëve (komuniteti **LGBT** Plus).

Si pikënisje e dytë për realizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve është **e drejta për shtetësi** (neni 4). Kjo vërehet që nga titulli i kapitullit të dytë të Kushtetutës, në të cilin, siç u tha, bëhet dallimi në mes të qytetarëve dhe individëve. Kjo është krejt e natyrshme për shkak se shtetësia nënkupton mbrojtje të veçantë kushtetuese, përkatësisht shërben si një kusht i domosdoshëm për fitimin e statusin të caktuar juridik përmes së cilit mundësohet realizimi i lirive dhe të drejtave kushtetuese në një nivel dhe cilësi të caktuar, që dallon nga individët që nuk kanë statusin e qytetarit me shtetësi maqedonoveriore. Një status i tillë vjen e dallohet edhe më shumë kur bëhet fjalë për detyrimin për mbrojtje të vendit, ekstradimin dhe vëllimin e lirive dhe të drejtave të të huajve, që janë të ndryshëm nga ato të shtetasve maqedonoverior (nenet 28 dhe 29). Në një mënyrë të përafërt, kjo është kështu në çdo shtet.

7.1.3. Kushtet e realizimit të lirive dhe të drejtave njerëzore në Mal të Zi

Edhe në rastin e **Malit të Zi**, kushtet e realizimit të lirive dhe të drejtave të njeriut duhen kërkuar në kuadrin juridik - kushtetues malazez, që përfshinë në rend të parë konceptin e sovranitetit shtetëror dhe rolin e individit në shtet, rolin dhe pozitën e të drejtës ndërkombëtare në rendin e brendshëm, kushtet dhe mundësitë kushtetuese për realizimin e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave kushtetuese dhe, së fundi, pikat nisëse për realizimin e tyre (parimi i mosdiskriminimit dhe shtetësia).

Preambula e Kushtetutës së Malit të Zi (KMZi) është mjaft e shkurtër dhe shpalos vlerat kushtetuese që sanksionohen, siç janë: liria, paqja, toleranca, respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut, multikulturaliteti, demokracia dhe sundimi i ligjit, për të kaluar në barazinë dhe lirinë e qytetarëve, popujve dhe pakicave kombëtare që jetojnë në këtë vend (malazezëve, serbëve, boshnjakëve, shqiptarëve, myslimanëve, kroatëve dhe të tjerëve), përgjegjësinë e shtetit për ambientin jetësor dhe zhvillimin e balancuar të shoqërisë dhe shtetit dhe drejtësinë sociale dhe, së fundi, besnikërisë ndaj bashkëpunimit në mes të popujve dhe integrimeve të vendit në strukturat euro-atlantike. Këtë fytyrë qytetare të Shtetit, KMZi e sforcon në nenet e para të saj, më shumë se çdo vend tjetër fqinjë me Kosovën: sovraniteti i takon shtetasve të vendit (neni 2 parag. 1), kurse karakteri qytetar fuqishëm vihet në spikamë në

paragrafin e dytë të nenit 1, krahas cilësive të tjera të Shtetit malazez (shtet demokratik, ekologjik dhe i drejtësisë sociale që bazohet në sundimin e së drejtës).

Roli dhe pozita e individit përcaktohen me nenet 6 ("Liritë dhe të drejtat themelore"), 7 ("Ndalimi i nxitjes së urrejtjes"), 8 ("Ndalimi i diskriminimit"), 10 ("Kufijtë e lirisë"), 12 ("Shtetësia malazeze") dhe 16 ("Ligji") të **KMZi**. Njëjtë si në vendet fqinje, përfshirë Kosovën, edhe në Mal të Zi këto dispozita shprehin të njëjtën gjë: garantimi e një roli dhe pozitë kushtetuese të individit që mundëson kufizimin e pushtetit shtetëror dhe realizimin e sovranitetit demokratik të shtetit ku në fokus ngelet qytetari, liritë dhe të drejtat e tij, barazia dhe mosdiskriminimi.

Në nenin 6 të dispozitave themelore të KMZi, në tri paragrafe vihen themelet e statusit kushtetues të individit dhe subjekteve të tjerë të së drejtës në Mal të Zi. Paragrafi i parë konfirmon se Mali i Zi garanton dhe mbron liritë dhe të drejtat e njeriut. I dyti paragraf i shpall të pacenueshme liritë dhe të drejtat e njeriut. Në fund, paragrafi i tretë vë detyrimin e çdokujt për të respektuar liritë dhe të drejtat e tjerëve. Neni 7, në një paragraf të vetëm ndalon nxitjen e urrejtjes dhe jotolerancës, në çfarëdo baze qoftë. Neni në vijim, neni 8, sanksionon mosdiskriminimin në tre paragrafë. I pari paragraf bën fjalë për ndalimin e diskriminimit, duke bërë kategorizimin e tij në dy lloje – mosdiskriminimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Në paragrafin e dytë përjashton nga diskrminimimi masat që kanë për qëllim promovimin dhe realizimin e barazisë individuale dhe kolektive, përkatësisht të masat e njohur gjerësisht si diskriminim pozitiv. Së fundi, paragrafi i tretë tregon se masat e diskriminimit pozitiv kanë karakter të përkohshëm dhe lidhen me arritjen e qëllimit përfundimtar – realizimin e barazisë dhe mbrojtjes së personit apo personave që gjenden në pozitë të pabarabartë për çfarëdo arsye. Neni 10 i KMZi, në një mënyrë të ngjashme me KMVer, vë kufijtë e lirisë, të cilët përcaktohen sipas dy parametrave kushtetues: sipas parametrit të parë, është e lejueshme çdo gjë që nuk ndalohet me Kushtetutë dhe, sipas të dytit, çdo kush detyrohet t'i përmbahet Kushtetutës dhe ligjeve. Dispozitat mbi shtetësinë malazeze nga neni 12 i KMZi nuk bëjnë asgjë tjetër përveç që tregojnë për statusin e mbrojtur që ka shtetasi malazez kundrejt të tjerëve, meqë vetë Shteti definohet si shtet qytetar. Neni 16 definon se çfarë është **reservatio legis**, duke definuar fushat që normohen me ligj, në pajtim me Kushtetutën: në mënyrë shprehimore përcaktohet se mënyra e realizimit të lirive dhe të drejtave të njeriut si dhe i lirive dhe të drejtave të posaçme të pakicave përcaktohet me ligj, në pajtim më Kushtetutën. Për këtë arsye në këtë vend, njëjtë si në Kosovë dhe vendet tjera përreth Kosovës ekzistojnë ligje dhe kode sektoriale që normojnë specifikisht mënyrat e realizimit të lirive dhe të drejtave të njeriut.

Sa i përket rolit dhe pozitës së të drejtës ndërkombëtare në rendin e brendshëm të Malit të Zi, zgjidhja kushtetuese është e ngjashme me vendet tjera përreth Kosovës, me përjashtim të vetë Kosovës, e cila, siç u pa, iu ka dhënë status kushtetues disa instrumenteve dhe dokumenteve regjionale dhe ndërkombëtare. Qysh në dispozitat themelore kushtetuese, në nenin 9, KMZi normon marrëdhënien në mes të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës së brendshme malazeze: marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe të shpallura dhe rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare janë pjesë përbërëse e rendit të brendshëm të këtij vendi, kanë epërsi ndaj legjislacionit të brendshëm dhe zbatohen drejtpërdrejtë atëherë kur në mënyrë të ndryshme nga legjislacioni nacional rregullojnë marrëdhëniet që kanë objektin e njëjtë të rregullimit. Kjo nënkupton se këtu vlen, *mutatis mutandis*, krejt ajo që u tha për **Maqedoninë e Veriut** mbi këtë çështje, përkatësisht se gjejnë zbatim standardet dhe parimet regjionale dhe ndërkombëtare mbi liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve për aq sa ato kanë të bëjnë me **Malin e Zi**.

Lidhur me kushtet dhe mundësitë kushtetuese për realizimin e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave kushtetuese, në **Mal të Zi** ekziston garancioni më i qartë në krahasim me kushtetutat e vendeve fqinje me Kosovën: në nenin 56 të KMZi garantohet e drejta e secilit në Mal të Zi për t'iu drejtuar organizatave ndërkombëtare më qëllim të realizimit të lirive dhe të drejtave kushtetuese, pra jo të lirive dhe të drejtave të garantuara ndërkombëtarisht. Kjo dispozitë e bënë mjaftueshëm të qartë se garancionet kushtetuese të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve në **Mal të Zi** kanë për pikë referimi standardet

më të larta regjionale dhe ndërkombëtare. Këtë e vërteton edhe fakti se lista, radhitja dhe klasifikimi i lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve në kapitullin e dytë të Kushtetutës ka ndjekur modelin e gjeneratave të tyre dhe, njëjtë si në Maqedoninë e Veriut, nuk mungon asnjë liri ose e drejtë që garantohet me **KEDNJ**, **DUDNJ**, **PDCP**, **PDSEK** apo ndonjë dokument tjetër regjional ose ndërkombëtar që ka relevancë në këtë fushë.

Së fundi, pikat nisëse për realizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut në Mal të Zi, **mosdiskriminimi** dhe **shtetësia**, në shikim të parë duken kontradiktore, sikur përjashtojnë njëra - tjetrën. Por, kjo nuk është kështu, për shkak se parimi i diskriminimit nga neni 8 i **KMZi** komandon realizimin e çdo lirie dhe të drejte njerëzore, njëjtë si në Kosovë dhe vendet tjera përreth, pa prekur shtetësinë si pikë nisëse të këtij realizimi. Futja e parimit të shtetësisë në nenin 12 të KMZi nuk bëhet për qëllime diskriminimi dhe vënies së të huajve në pozitë të pabarabartë me rastin e realizimit të lirive dhe të drejtave të njeriut, por kryekëput me qëllim të krijimit të kushteve për realizim efektiv të lirive dhe të drejtave të përcaktuara kushtetuese. Kjo konfirmohet në garancionin e barazisë së të gjithëve para Kushtetutës dhe ligjit, nga neni 17 i KMZi. Edhe këtu, dallimi në mes të shtetasve dhe të huajve ka për qëllim të qartësojë vëllimin dhe cilësinë e lirive dhe të drejtave të njeriut si dhe detyrimet specifike kushtetuese që duhet të kenë qytetarët e vendit kundrejt shtetit dhe shoqërisë, krahasuar me të tjerët.

7.1.4. Kushtet e realizimit të lirive dhe të drejtave njerëzore në Serbi

Situata dhe zgjidhjet kushtetuese në Serbi ngjasojnë shumë me situatën dhe zgjidhjet kushtetuese malazeze: kuadri juridik-kushtetues serb përfshin, në rend të parë, konceptin e sovranitetit shtetëror dhe rolin e individit në shtet, rolin dhe pozitën e të drejtës ndërkombëtare në rendin e brendshëm, kushtet dhe mundësitë kushtetuese për realizimin e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave kushtetuese dhe, së fundi, pikat nisëse për realizimin e tyre (parimi i mosdiskriminimit dhe shtetësia).

Preambula e Kushtetutës së Serbisë (KSerb) gjithashtu është mjaft e shkurtër mirëpo shpalos vlera të tjera kushtetuese nga rasti malazez: një e treta e saj merret me Kosovën, të cilën e trajton si pjesë të Shtetit serb, i cili definohet si shtet i popullit serb. Kjo e fundit nuk thuhet në preambulë por në pjesën operative të dispozitave themelore kushtetuese. Në preambulë tregohen shenjat e natyrës së Shtetit serb, që nuk është **shtet qytetar** dhe proklamohet barazia e qytetarëve dhe e komuniteteve etnike. Fizionomia e Republikës së Serbisë si shtet i popullit serb përcaktohet në nenin 1 të KSerb, dhe bazohet në sundimin e ligjit dhe drejtësinë sociale, parimet e demokracisë qytetare, liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve dhe përkatësinë vlerave dhe parimeve evropiane.

Roli dhe pozita e individit përcaktohet me nenin 2 të **KSerb**, në të cilin sovraniteti rrjedh nga qytetarët dhe ushtrohet me referendum, përmes iniciativës qytetare dhe përfaqësuesve të vet të zgjedhur. Një dispozitë tjetër kushtetuese, përcaktuese e rolit dhe pozitës së individit në këtë vend, është dispozita kushtetuese e nenit 3 që normon sundimin e së drejtës, e cila shpallet premisë themelore kushtetuese që niset nga liritë dhe të drejtat e njeriut. Kjo premisë kushtetuese, sipas paragrafit të dytë të nenit 3 si më sipër, realizohet me zgjedhjet e lira dhe të drejtpërdrejta, garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve, ndarjen e pushteteve, gjyqësinë e pavarur dhe nënshtrimin ndaj pushtetit të Kushtetutës dhe ligjit. Njëjtë si në vendet fqinje të Kosovës, përfshirë vetë Kosovën, edhe në Serbi këto dispozita shprehin të njëjtën gjë: garantimin e një roli dhe pozite kushtetuese të individit që mundëson kufizimin e pushtetit shtetëror dhe realizimin e sovranitetit demokratik të shtetit, ku në fokus ngelet qytetari, liritë dhe të drejtat e tij, barazia dhe mosdiskriminimi. Kjo është analizë pozitiviste zgjidhjeve kushtetuese serbe dhe nuk ka lidhje me gjendjen empirike në këtë vend, siç është e tillë edhe analiza jonë e krejt vendeve fqinje me Kosovën, përfshirë vetë atë.

Në **KSerb** është theksuar mbështetja në marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare, përkatësisht në interpretimin e lirive dhe të drejtave të njeriut konform standardeve dhe praktikave ndërkombëtare dhe në mbrojtjen e tyre (neni 18 parag. 3). Rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare janë pjesë përbërëse e rendit të brendshëm kushtetues serb dhe zbatohen drejtpërdrejt (neni 16 parag. 2). Drejtpërdrejt zbatohen edhe liritë dhe të drejtat individuale dhe të minoriteteve të garantuara me Kushtetutë (neni 18 parag. 1). Këto zgjidhje kushtetuese, siç shihet, nuk bëjnë dallim në mes të lirive dhe të drejtave kushtetuese dhe atyre që gjenden në marrëveshjet dhe instrumentet relevante ndërkombëtare. Në vijim do të shihet se edhe në Serbi, njëjtë si në vendet përreth, përveç Kosovës, bëhet kategorizimi i lirive dhe të drejtave sipas gjeneratave dhe përmbajtja e tyre nuk ndryshon në thelb nga lista e tyre që gjendet në DUDNJ, KEDNJ, PDCP dhe PDESK.

Pjesa e dytë e **KSerb** (nenet 18-81), në tërësi i kushtohet të drejtave njerëzore dhe të minoriteteve. Si në Kosovë dhe në vendet përreth, dispozita të kësaj materie, pra të materies mbi liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, gjenden edhe në dispozitat tjera kushtetuese, siç janë ato që kanë të bëjnë me financat publike dhe rregullimin ekonomik serb, organizimin dhe funksionimin e pushtetit, Gjykatën Kushtetuese, rregullimin territorial, kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, ndryshimin e Kushtetutës. E njëjta vlen edhe për ligjet tjera serbe që kanë të bëjnë me materien e lirive dhe të drejtave të njeriut, siç janë ligjet serbe për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të minoriteteve, avokatin e popullit, ndalimin e diskriminimit, barazinë gjinore etj.

Edhe këtu pikë nisëse për realizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve është dispozita mbi **ndalimin e diskriminimit** (neni 21). Përmbajtja e kësaj dispozite është e ngjashme me zgjidhjen kushtetuese malazeze: e para, të gjithë janë të barabartë para ligjit (parag. 1); e dyta, çdo kush gëzon mbrojtjen ligjore në mënyrë të barabartë (parag. 2); e treta, çdo formë e diskriminimit ndalohet, e drejtpërdrejtë dhe e tërthortë, pa marrë parasysh bazën e diskriminimit e në veçanti sa i përket si vijon: racës, gjinisë, përkatësisë nacionale, prejardhjes shoqërore, lindjes, religjionit dhe bindjeve të tjera, besimit politik ose tjetër, gjendjes pasurore, kulturës, gjuhës, moshës ose invaliditetit psikik apo fizik (parag. 3). Në paragrafin 4 sanksionohet e drejta për diskriminim pozitiv, me një formulim gjuhësor thuajse të njëjtë si në Mal të Zi: masat e diskriminimit pozitiv kanë karakter të përkohshëm dhe lidhen me arritjen e qëllimit përfundimtar - realizimin e barazisë dhe mbrojtjes së personit apo personave që gjenden në pozitë të pabarabartë për çfarëdo arsye. Neni 19 i **KSerb** në mënyrë shumë më të ndryshme se **Maqedonia e Veriut** dhe **Mali i Zi** normon garancionet kushtetuese: në këtë nen nuk përcaktohen parametrat kushtetues të garancioneve në fjalë, por bëhet fjalë për qëllimin që kanë ato. Qëllim themelor i lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të qytetarit të garantuara me KSerb është ruajtja e dinjitetit njerëzor dhe realizimi i lirisë dhe barazisë së plotë të secilit individ në një shoqëri të drejtë, të hapur dhe demokratike, që bazohet në parimin e sundimit të së drejtës.

Edhe në **KSerb**, dallimi në mes të shtetasve dhe të huajve ka për qëllim të qartësojë vëllimin dhe cilësinë e lirive dhe të drejtave të njeriut si dhe detyrimet specifike kushtetuese që duhet të kenë qytetarët e vendit kundrejt shtetit dhe shoqërisë, krahasuar me të tjerët. Njëjtë si në çdo shtet tjetër në botën bashkëkohore, për ata që e posedojnë, **shtetësia** ofron një mbrojtje të veçantë juridike. Në Serbi, shtetësia normohet me nenin 38 të Kushtetutës.

7.2. Kufizimet e lirive dhe të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës

Realizimi i lirive dhe të drejtave të kushtetuese mund të kufizohet, por vetëm për arsyet dhe nën kushtet e përcaktuara në KKos. Këto arsye dhe kushte për kufizim janë të formuluara në mënyrë të përgjithshme në nenin 55, kurse më pastaj gjatë normimit të lirive dhe të drejtave konkrete, pranë secilës liri ose të drejtë, përcaktohet nëse kufizohet ose jo. Regjimi i përgjithshëm i kufizimeve të lirive dhe të drejtave niset nga premisa themelore se një gjë e tillë duhet të jetë e autorizuar shprehimisht me Kushtetutë. Kjo premisë shprehet në dispozitën e nenit 55 parag.1 të KKos, që thotë se "[...] Të drejtat dhe liritë

themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj". Përveç autorizimit kushtetues, kufizimi për të qenë legjitim në aspektin kushtetues, duhet të bëhet për ndjekjen e qëllimeve të cilat, gjithashtu, janë përcaktuara me Kushtetutë. Ato qëllime konsistojnë në atë që thotë paragrafi i dytë i nenit të njëjtë, përkatësisht se "[...] Të drejtat dhe liritë themelore..., mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi". Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël (parag. 3 i nenit 55). Nëse arsyet për kufizim, ta zëmë, kanë të bëjnë me ruajtjen e sigurisë nacionale, atëherë kufizimi ndjek një qëllim legjitim. Mirëpo, nëse ruajtja e sigurisë nacionale mund të bëhet me kufizim më të vogël, atëherë nuk do të merret vendim për kufizim të tërësishëm të lirive dhe të drejtave përkatëse. Në çdo rast, kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bënë ta mohojë kurrsesi esencën e së drejtës së garantuar (neni 55, paragrafi fundit). Një kufizim i tillë do të ekzistonte, ta zëmë, kur në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, personat e kufizuar në lirinë e tyre të lëvizjes do të detyroheshin të punonin punë të detyrueshme apo të futeshin në kushte të jetesës si skllav.

Në KKos janë dhënë arsyet, siç u tha, për shkak të të cilave gjykata ose organet tjera shtetërore mund të kufizojnë lirinë dhe të drejtën konkrete. Ato çdo herë janë të drejtuara kah ruajtja e një interesi të përgjithshëm shoqëror, i cili në këtë mënyrë i mbivendoset një lirie ose të drejte konkrete individuale ose grupore. Ato arsye, që figurojnë në dispozitat konkrete kushtetuese të kapitujve dy dhe tre të Kushtetutës, kanë të bëjnë kryesisht me sa vijon: mbrojtja e lirive dhe të drejtave individuale dhe të komuniteteve, zhvillimin e procedurën penale, mbrojtja e rendit dhe qetësisë publike, mbrojtja e jetës dhe shëndetit të njerëzve, mbrojtja e moralit, shoqërisë demokratike, pengimi i përhapjes së sëmundjeve ngjitëse, mbrojtja e shtetit, mbrojtja e sigurisë së shtetit, largimi i rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për njerëz dhe pasuri, pengimi i nxitjes dhe kryerjes së urrejtjes etnike, fetare dhe tjetër, mbrojtja e rendit kushtetues dhe integritetit territorial, mbrojtja e ambientit jetësor dhe pasurive natyrore.

Kufizimi i lirive dhe të drejtave të njeriut bëhet përkohësisht, deri sa zgjasin arsyet për kufizim. Kualiteti apo niveli i lirive dhe të drejtave kushtetuese që është arritur deri në miratimin e Kushtetutës apo ndryshimeve të saj nuk guxon në zvogëlohet. Kështu, ta zëmë, privimi nga liria pa urdhër të gjykatës, që zgjatë 48 (dyzetë e tetë orë) sipas nenit 29.2 të Kushtetutës, nuk mund të shkurtohet me ndryshimin e Kushtetutës, apo me ligj; e drejta për themelim të medies që i njihet çdokujt sipas nenit 42.1 të Kushtetutës, nuk mund të kufizohet vetëm në shtetas të Kosovës etj.

Nga liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të komuniteteve mund të ketë shmangie në kohën e gjendjes së jashtëzakonshme, ato mund të suspendohen (neni 56). Të gjitha trajtat e **gjendjes së jashtëzakonshme** normohen me KKos. Sipas nenit të saj 131.1, ato trajta janë si vijon:

- kur ka nevojë për masa emergjente të mbrojtjes;
- kur ka rrezik të brendshëm ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike; dhe
- kur ka fatkeqësi natyrore, e cila prek tërë territorin e Republikës së Kosovës ose një pjesë të tij.

Ekziston dallim në rregullimin e tyre kushtetues. Kjo lidhet me natyrën e ndryshme të secilës prej tyre. Ekzistojnë, megjithatë, disa standarde kushtetuese që nuk preken gjatë secilës prej tri trajtave të gjendjes së jashtëzakonshme. Ato janë në normuara me nenin 131.2 të KKos dhe kanë të bëjnë me dy gjëra: e para, gjatë gjendjes së Jashtëzakonshme, Kushtetuta nuk suspendohet, kurse kufizimet mbi të drejtat dhe liritë e garantuara, bëhen vetëm deri në shkallën e nevojshme, për sa më pak kohë që të jetë e nevojshme dhe në përputhje të plotë me Kushtetutën; dhe, e dyta, gjatë gjendjes së jashtëzakonshme,

ligji për zgjedhjet e Kuvendit dhe të komunave nuk mund të ndryshohet. Në këtë kuptim, por me formulime të ndryshme, gjenden të normuara edhe në kushtetutat e vendeve fqinje me **Kosovën**. Parimet e tjera për veprimet e institucioneve publike gjatë gjendjes së jashtëzakonshme rregullohen me ligj, i cili nuk ekziston për momentin (maj 2022).

Nëse paraqitet nevoja për marrjen e masave emergjente të mbrojtjes, që përbën shkakun e parë për futjen e gjendjes së jashtëzakonshme, Presidenti, pas konsultimit me Kryeministrin, shpall gjendjen e Jashtëzakonshme. Me shpalljen e saj, ai shpallë menjëherë dekretin, i cili përcakton natyrën e kërcënimit dhe çfarëdo kufizimi për të drejtat dhe liritë. Brenda dyzet e tetë (48) orësh, Kuvendi mund të japë pëlqimin me dy të tretat (2/3) e votave të deputetëve të pranishëm (neni 131.3).

Nëse ka rrezik ndaj rendit kushtetues dhe sigurisë publike, ose ekziston një fatkeqësi natyrore në tërë territorin e Republikës ose një pjesë të tij, shkaku i dytë dhe i tretë për futjen e gjendjes së jashtëzakonshme, atëherë Presidenti, në konsultim me Kryeministrin, mund të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme. Me shpalljen e saj, Presidenti shpallë menjëherë një dekret, i cili përcakton natyrën e gjendjes së jashtëzakonshme dhe çfarëdo kufizimi mbi të drejtat dhe liritë. Brenda dyzet e tetë (48) orësh, Kuvendi mund të japë pëlqimin e tij me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Nëse nuk jepet pëlqimi, dekreti i Presidentit nuk ka forcë as efekt.

Gjatë kohës sa zgjatë gjendja e jashtëzakonshme, **shmangiet nga liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të komuniteteve** lejohet vetëm në vëllimin e domosdoshëm. Kjo përcaktohet në nenin 56.1 të KKos. Kështu, ta zëmë, nuk mund të suspendohet liria e lëvizjes, nëse qëllimi i shmangies arrihet me kufizimin e saj. Shmangiet nga liritë dhe të drejtat, gjithashtu, nuk guxojnë të shpijnë në mosdiskriminim dhe pushojnë së ekzistuari me përfundimin e gjendjes së jashtëzakonshme.

KKos liston liritë dhe të drejtat nga të cilat nuk mund të ketë shmangie. Kjo sepse ato janë **liritë dhe të drejtat absolute**, nga të cilat në asnjë rrethanë nuk mund të ketë shmangie (neni 56.2). Si të tilla, Kushtetuta i konsideron, në mënyrë taksative, për sa vijon: dinjiteti i njeriut (neni 23), barazia para ligjit (neni 24), e drejta për jetën (neni 25), ndalimi torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues (27), ndalimi skllavërisë dhe punës së detyruar (neni 28), e drejta e lirisë dhe sigurisë (neni 29), e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31), parimi i legalitetit dhe proporcionalitetit në rastet penale (neni 33), e drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër (neni 34), e drejta e martesës dhe familjes (neni 37) dhe liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë (neni 38).

7.2.1. Kufizimet e lirive dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri

Njëjtë si në Kosovë dhe në të gjitha vendet përreth, realizimi i lirive dhe të drejtave kushtetuese mund të kufizohet, por vetëm për arsyet dhe nën kushtet e përcaktuara në kushtetutë. Ky standard ekziston në krejt kushtetutat e vendeve fqinje me Kosovën, afërisht me redaktime që ndryshojnë në nuanca. Haset edhe gjetiu në kushtetutat e vendeve demokratike të Evropës. Këto arsye dhe kushte për kufizim, të cilat përfaqësojnë një standard të fuqishëm të **GJEDNJ-së**, janë të formuluara në mënyrë të përgjithshme në nenin 17 të **KShq**, i cili i takon parimeve të përgjithshme të dispozitave mbi liritë dhe të drejtat e njeriut (kapitulli i dytë). Më pastaj, gjatë normimit të lirive dhe të drejtave konkrete, për secilën liri ose të drejtë përcaktohet në mënyrë të veçantë nëse kufizohet dhe përse.

Edhe këtu, regjimi i përgjithshëm i kufizimeve të lirive dhe të drejtave niset nga premisa themelore se një gjë e tillë duhet të jetë e autorizuar shprehimisht me kushtetutë. Kjo premisë shprehet në mënyrë të ngjashme me KKos, në fjalinë e parë të nenit 17 si më sipër të **KShq**: "[...] 1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj [...]". Përveç autorizimit kushtetues, për të qenë legjitim në aspektin kushtetues, kufizimi edhe në Shqipëri duhet të bëhet për ndjekjen e qëllimeve, të cilat gjithashtu janë përcaktuara me Kushtetutë. Ato qëllime konsistojnë në atë

që thotë fjalia e dytë e paragrafit të parë të nenit 17, në të cilin konstatohet se kufizimi mund të bëhet" [...] për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve". Fjalia e fundit e këtij paragrafi përcakton caqet e kufizimit, duke thënë se "duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë". Kjo është e ngjashme me formulimin kosovar, nga neni 55 i KKos, që thotë se "Të drejtat dhe liritë themelore..., mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi". Se kjo është kështu vërtetohet nga formulimi i paragrafit të dytë të nenit 17, ku kushtetutëbërësi shqiptar tërheq vërejtjen se, me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të tyre, nuk guxon të cenohet thelbi i lirive dhe të drejtave dhe, në asnjë rast, nuk mund të tejkalohen kufizimet e parashikuara në **KEDNJ**. Këto kufizime nuk janë asgjë tjetër veçse formulime që gjenden në nenin 55 të KKos, të cilat kushtetutëbërësi kosovar i ka marrë nga KEDNJ-ja thuajse literalisht.

Për dallim nga kufizimi i përgjithshëm si më sipër, ekzistojnë edhe kufizimet e lirive dhe të drejtave të njeriut, të cilat në Kosovë quhet shmangie nga liritë dhe të drejtat e njeriut. Edhe ky standard është mjaft universal dhe figuron në të gjitha kushtetutat evropiane dhe ka të bëjë me situatat e gjendjes së jashtëzakonshme (agresioni i jashtëm dhe lufta, fatkeqësitë natyrore dhe rreziku ndaj rendit kushtetues dhe sigurisë së brendshme). Në **KShq**, shmangiet nga liritë dhe të drejtat e njeriut përshkruhen në nenet 170-176 të pjesës së gjashtëmbëdhjetë ("Masat e jashtëzakonshme"). Të gjitha trajtat e **gjendjes së jashtëzakonshme** normohen me **KShq**, njëjtë si në vendet tjera. Sipas neneve 171, 173 dhe 174 të **KShq**, ato janë si vijon:

- agresioni i armatosur kundër Republikës së Shqipërisë dhe kërcënimet e jashtme ose kur detyrimi për mbrojtje të përbashkët buron nga një marrëveshje ndërkombëtare (neni 171);
- rreziku për rendin kushtetues dhe për sigurinë publike (neni 173 parag. 1); dhe
- fatkeqësia natyrore ose aksidenti teknologjik (neni 174 parag. 1).

Edhe në Shqipëri ekzistojnë standardet e ngjashme kushtetuese, që nuk vlejnë për secilën prej tri trajtave si më sipër të gjendjes së jashtëzakonshme. Ato janë në normuara me nenin 170 parag. 5 dhe 6 të Kushtetutës dhe kanë të bëjnë me dy gjëra: e para, gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, Kushtetuta nuk suspendohet, kurse kufizimet mbi të drejtat dhe liritë e garantuara, bëhen vetëm deri në shkallën e nevojshme, për sa më pak kohë që të jetë e nevojshme dhe në përputhje të plotë me Kushtetutën; dhe, e dyta, gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, ligji për zgjedhjet e Kuvendit dhe të komunave nuk mund të ndryshohet dhe as Presidenti i Shqipërisë nuk mund të zgjidhet. Në këtë kuptim, por me formulime të ndryshme, gjenden të normuara edhe në kushtetutat e vendeve fqinje me Kosovën, siç do të shohim në vijim. Parimet e tjera për veprimet e institucioneve publike gjatë gjendjes së jashtëzakonshme rregullohen me ligj.

Kushtetuta liston liritë dhe të drejtat nga të cilat mund të kufizohen dhe të cilat nuk mund të kufizohen fare. Të parat kanë të bëjnë me dy situatat e para (agresioni i armatosur kundër Republikës së Shqipërisë, kërcënimet e jashtme ose kur detyrimi për mbrojtje të përbashkët buron nga një marrëveshje ndërkombëtare dhe rreziku për rendin kushtetues dhe për sigurinë publike). Të dytat ndërkaq, i referohen fatkeqësive natyrore ose aksidenteve teknologjike. Kushtetuta kërkon që, aktet për shpalljen e gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, të cilësojnë të drejtat dhe liritë që kufizohen (neni 175 parag. 3).

Liritë që fare nuk mund të kufizohen, **liritë dhe të drejtat absolute**, pra nga të cilat në asnjë rrethanë nuk mund të ketë shmangie dhe të cilat organet shtetërore detyrohen t'i respektojnë dhe promovojnë në çdo situatë, listohen në nenin 175 parag. 1 të **KShq**, ngjashëm siç ndodhë me Kosovën dhe zgjidhjet kushtetuese të vendeve përreth. Edhe në Shqipëri, listimi është taksativ dhe përfshinë liritë dhe të drejtat për sa vijon: barazia dhe mosdiskriminimi (neni 18), shtetësia (neni 19), barazia kombëtare (neni 20), jeta (neni 21), Liria e ndërgjegjes dhe e fesë (neni 24), ndalimi torturës, dënimit apo trajtimit mizor,

çnjerëzor poshtërues (neni 25), ndalimi vetëfajësimit dhe parimi i legalitetit (neni 29), prezumimi i pafajësisë (neni 30), garancionet penalo-procedurale nga nenet 31 dhe 32, që mbrojnë pozitën e të akuzuarit në procedurë dhe nuk lejojnë vetinkriminimin dhe përdorimin e provave ligjërisht të papranueshme, si dhe garancionet që kanë të bëjnë me barazinë e të akuzuarit në një proces penal, parimi **ne bis in idem** (neni 34), ndalimi i dëbimit të shtetasve shqiptar nga territori shtetit (neni 39 parag. 1), prona private dhe garancionet kushtetuese nga neni 41 parag. 1, 2, 3 dhe 5, e drejta për një proces të rregullt gjyqësor (neni 42), e drejta e ankesës (neni 43), e drejta për parashtresa ndaj organeve publike (neni 48), mbrojtja e veçantë e fëmijëve, të rinjve, grave shtatzëna dhe nënave të reja (neni 54) dhe, së fundi, kujdesi shëndetësor (neni 55), dinjiteti i njeriut (neni 23), barazia para ligjit (neni 24), e drejta për jetën (neni 25), ndalimi torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues (27), ndalimi skllavërisë dhe punës së detyruar (neni 28), e drejta e lirisë dhe sigurisë (neni 29), e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31), parimi i legalitetit dhe proporcionalitetit në rastet penale (neni 33), e drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër (neni 34), e drejta e martesës dhe familjes (neni 37) dhe liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë (neni 38). Në paragrafin 2 të nenit 175 të Kushtetutës listohen liritë dhe të drejtat që mund të kufizohen gjatë fatkeqësive natyrore.

Lista e kufizimeve të kategorisë së dytë, që i referohen fatkeqësive natyrore ose aksidenteve teknologjike, gjendet në nenin 175 parag. 2. Të **KShq**, i cili thotë se "Gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore mund të kufizohen të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet: 37, 38, 41 paragrafi 4, 49, 51". Bëhet fjalë për paprekshmërinë e banesës (neni 37), vendbanimin dhe lëvizjen e lirë (neni 38), shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin (neni 41 parag. 4), e drejta për fitimin e mjeteve të jetesës sipas zgjidhjes vetjake të profesionit, vendit të punës dhe sistemit të kualifikimit profesional (neni 49) dhe, së fundi, e drejta e të punësuarit për grevë (neni 51).

Shefi i shtetit dhe organet tjera kushtetuese, gjatë gjendjes së jashtëzakonshme kanë prerogative të posaçme dhe afate për ndërmarrjen e tyre. Kjo përcaktohet me kushtetutë, e cila ua njeh fuqitë ekzekutive organeve kushtetuese që në kushte të zakonshme nuk kanë fuqi të tilla. Kjo është kështu edhe në Kosovë, siç e pamë, por edhe në vendet tjera përreth Kosovës. Një rol i posaçëm, **KShq** e rezervon për organin përfaqësues dhe për shefin e shtetit, aktet juridike të të cilëve i nënshtrohen ratifikimit në kohë paqeje, përfshirë dhe pasojat që kanë prodhuar ato gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme. Ligji përkatës, sipas autorizimit kushtetues, normon në mënyrë specifike të gjitha detajet e realizmit të gjendjes së jashtëzakonshme, kompensimin e qytetarëve për dëmin eventual dhe kështu me radhë (nenet 171-174).

7.2.2. Kufizimet e lirive dhe të drejtave të njeriut në Maqedoninë e Veriut

Edhe në **KMVer**, kufizimet kanë të bëjnë me gjendjen e përgjithshme dhe kufizimet që lidhen me gjendjen e jashtëzakonshme. Për dallim nga Kosova dhe Shqipëria, këtu kufizimet janë shkrirë në një, përcaktohen nga një nen dhe nuk bëhet dallim në mes të gjendjes së zakonshme apo të përgjithshme dhe gjendjes së jashtëzakonshme apo të posaçme. Neni përcaktues i kufizimeve në fjalë në **KMVer** është neni 54, i cili gjendet në kapitullin e dytë mbi liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të qytetarit. Kapitulli i shtatë që normon mbrojtjen e vendit, gjendjen e luftës dhe gjendjen e jashtëzakonshme nuk përmban asnjë dispozitë mbi kufizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, por fokusohet ekskluzivisht në autorizimet kushtetuese e ligjore të organeve kushtetuese qendrore në situatat si më sipër. Këto autorizime, konceptualisht janë të njëjta me zgjidhjet kushtetuese në Shqipëri dhe Kosovë, mirëpo situatat të cilave iu referohen janë më të ngushta: kushtetutëbërësi maqedonoverior në dy paragrafët e para të neneve kushtetuese 124 dhe 125 bën fjalë vetëm për luftën dhe gjendjen e jashtëzakonshme. Në këtë të fundit bëjnë pjesë fatkeqësitë e mëdha natyrore dhe epidemitë, kurse rrezikimi i rendit të brendshëm kushtetues fare nuk hyn në këtë kategori.

Neni 54 i **KMVer** në paragrafin e parë tregon se liritë dhe të drejtat e njeriut e të qytetarit mund të kufizohen vetëm në rastet e përcaktuara me Kushtetutë, kurse në paragrafin e dytë bëhet e qartë se kufizimet i referohen vetëm kohës së gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme, sipas definimeve të dispozitave të neneve 124 dhe 125. Paragrafi i tretë përmban një ndalesë të fuqishme: kufizimi i lirive dhe të drejtave nuk mund të jetë diskriminues në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, gjuhës, fesë, prejardhjes kombëtare ose sociale, pozitës pronësore ose shoqërore. Paragrafi i fundit, për dallim nga Kosova dhe Shqipëria, flet për llojin e lirive dhe të drejtave që nuk mund të kufizohen në asnjë situatë: kufizimi i lirive dhe të drejtave nuk mund të përfshijë të drejtën e jetës, ndalimin e torturës, veprimin dhe ndëshkimin çnjerëzor dhe nënçmues, përcaktimin juridik të veprave të ndëshkueshme dhe dënimeve, si dhe lirinë e bindjes, ndërgjegjes, mendimit, shprehjes publike të mendimit dhe të besimit fetar.

Kufizimet e lirive dhe të drejtave specifike, figurojnë brenda përcaktimeve kushtetuese të secilës prej lirive dhe të drejtave veç e veç, nganjëherë duke iu referuar ligjit, por në të shumtën e rasteve vetë Kushtetuta definon caqet e kufizimit. Sidoqoftë, në **KMVer** nuk ekziston një dispozitë e posaçme, e ndarë nga dispozitat që normojnë gjendjen e jashtëzakonshme në të gjitha trajtat e saj, me të cilën përcaktohen parametrat e përgjithshëm për kufizimin sistematik të lirive dhe të drejtave të njeriut, që në Kosovë gjenden në nenin 55, kurse në Shqipëri në nenin 17 të kushtetutës respektive.

7.2.3. Kufizimet e lirive dhe të drejtave të njeriut në Mal të Zi

Në Mal të Zi ekzistojnë zgjidhjet kushtetuese më të përafërta me Kosovën dhe Shqipërinë, por të paraqitura në tekst me një elokuencë e qartësi më të madhe. E kemi fjalën për dy nene kushtetuese që flasin për **kufizimin** e lirive dhe të drejtave të njeriut (neni 24) dhe për **kufizimin e përkohshëm** të lirive dhe të drejtave të njeriut (neni 25). Nenet 132 dhe 133 të **KMZi**, ndërkaq, normojnë gjendjen e posaçme, me të cilën nënkuptohet gjendja e luftës dhe gjendja e jashtëzakonshme. Edhe në Mal të Zi bëhet dallimi në mes të gjendje së luftës (neni 132) dhe gjendjes së jashtëzakonshme (neni 133). Me këtë të fundit, për dallim nga **KMVer**, në **KMZi** nënkuptohen jo vetëm katastrofat natyrore, epidemitë ekologjike dhe tekniko-teknologjike, por edhe situatat shoqërore në të cilat rrezikohet apo cenohet seriozisht rendi i brendshëm kushtetues i Malit të Zi. Këto dy nene konceptualisht nuk dallojnë me vendet fqinje me Kosovën, përfshirë vetë atë, sa i përket autorizimeve kushtetuese të organeve qendrore kushtetuese gjatë gjendjes së luftës dhe gjendjes së jashtëzakonshme.

Në nenin 24 të **KMZi** sanksionohet standardi nga **KEDNJ-ja**, ku gjenden parametrat që duhet të merren parasysh nga ligjvënësi malazez kur të vendos mbi kufizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Kjo është në linjë me përcaktimet kushtetuese të rezervës ligjore nga neni 16 i **KMZi**, në të cilin bëhet e qartë se sferë e ligjvënies është përcaktimi ligjor i mënyrës së realizimit të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve (paragrafi 1 nën pikat 1 dhe 2). Parametrat që duhet të merr parasysh ligjvënësi malazez, që formojnë **parimin e proporcionalitetit**, janë për sa vijon: kufizimi duhet të bëhet me ligj, të ndjek një qëllim legjitim, të jetë i domosdoshëm dhe në masë të duhur për një shoqëri demokratike dhe mos të ndjek qëllim apo synim tjetër nga ai për të cilin është vënë kufizimi. Nuk figuron kriteri i mosdëmtimit të esencës së të drejtës, që është një standard evropian, por një gjë e tillë nënkuptohet, nisur nga fakti se për secilën liri dhe të drejtë ekziston përcaktimi kushtetues lidhur me kufizimin dhe arsyet për një gjë të tillë.

Neni 25 i **KMZi**, në pesë paragrafë, normon kufizimin e përkohshëm të lirive dhe të drejtave të njeriut në kushtet e luftës dhe gjendjes së jashtëzakonshme. Në paragrafin e parë tregohet se kufizimi duhet të jetë proporcional, vetëm për aq sa është e domosdoshme në një shoqëri demokratike, kurse paragrafi i dytë vë një ndalesë: nuk mund të bëhet kufizimi në mënyrë diskriminuese në bazë të gjinisë, nacionalitetit, fesë, gjuhës, prejardhjes etnike ose shoqërore, bindjes politike ose bindjes tjetër, gjendjes pasurore ose në bazë të çfarëdo cilësie tjetër. Paragrafi në vijim përmend një nga një liritë dhe të drejtat që nuk mund të kufizohen fare, të cilat janë: e drejta për jetë, mjet dhe ndihmë juridike, dinjitet dhe respektim të personalitetit, gjykim të drejtë dhe publik dhe parimi i legalitetit, prezumimi i pafajësisë, mbrojtja, kompensimi dëmit për

privim të paligjshëm dhe të pabazë nga liria dhe gjykim të padrejtë, liria e mendimit, fesë dhe ndërgjegjes dhe, në fund, lidhja e martesës. Ngjashëm me këtë paragraf, paragrafi në vijim ndalon heqjen e ndalesave kushtetuese, duke përcaktuar shprehimisht se ndalohet heqja e ndalesave që kanë të bëjnë me sa vijon: nxitjen ose shkaktimin e urrejtjes ose mosdurimit, diskriminimin, gjykimit dhe dënimit të serishëm për të njëjtën vepër dhe, së fundi, asimilimin e dhunshëm. Së fundi, paragrafi i pestë përcakton kohëzgjatjen e kufizimeve, duke thënë se ato mund të zgjasin vetëm gjatë kohës së luftës dhe gjendjes së jashtëzakonshme.

7.2.4. Kufizimet e lirive dhe të drejtave të njeriut në Serbi

Krahas kufizimeve veç e veç për secilën liri dhe të drejtë nga pjesa e dytë e **KSerb**, ekzistojnë edhe kufizimet e përgjithshme apo regjimi i përgjithshëm i kufizimit të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe kufizimet e posaçme apo regjimi i posaçëm i kufizimit të lirive dhe të drejtave. Regjimi i parë normohet me nenin 20, që rregullon parimet e përgjithshme të pjesës së dytë të **KSerb**. Regjimi i dytë normohet me nenin 2002, që gjendet në pjesën e tetë të **KSerb** që flet për kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë. Gjendja e jashtëzakonshme definohet si gjendje që rrezikon shtetin dhe qytetarin (paragrafi i parë i nenit 200), kurse gjendja e luftës nuk definohet fare, por nënkuptohet (paragrafi i parë i nenit 201). Edhe këtu, autorizimet e organeve qendrore kushtetuese janë në thelb të njëjta me ato të vendeve të tjera të përreth Kosovës, ku rolin parësor në caktimin e kufizimeve dhe vëllimit të tyre e ka organi përfaqësues, bazuar në Kushtetutë dhe ligj, por edhe organet tjera si shefi i shtetit, në rastet kur organi përfaqësues nuk mund të mblidhet. Njëjtë si **KKos**, edhe **KSerb** për kufizimet në situatat e gjendjes së jashtëzakonshme dhe të luftës përdor shprehjen shmangie nga liritë dhe të drejtat e njeriut, jo kufizim i lirive dhe të drejtave të njeriut. Në fakt, vet neni që normon këtë regjim të posaçëm mban titullin "Shmangia nga liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve" dhe ka vetëm një nen, nenin 202.

Regjimi i parë përmban parametrat e qartë kushtetues për ndërtimin e regjimit të përgjithshëm të kufizimit, të cilat janë në harmoni me standardet evropiane të **KEDNJ-së**. Ky regjim normohet në nenin 20 dhe mban titullin "Kufizimet e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve". Në paragrafin e parë përcaktohet parametri ligjor i kufizimit, pra vetëm me ligj mund të kufizohen liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, por me kusht që një gjë e tillë lejohet nga Kushtetuta, e cila përcakton edhe qëllimet e kufizimit, është e domosdoshme në një shoqëri demokratike për arritjen e qëllimit të kufizimit, pa prekur esencën (substancën) e të drejtës së garantuar. Në paragrafin e dytë thuhet se niveli i arritur i lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve nuk mund të zvogëlohet. Së fundi, paragrafi i tretë tregon se, me rastin e kufizimit të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve, të gjitha organet shtetërore, në veçanti gjykatat, detyrohen të marrin parasysh esencën e të drejtës që kufizohet, rëndësinë e qëllimit të kufizimit, natyrën dhe vëllimin e kufizimit, marrëdhënien e kufizimit më qëllimin për të cilin bëhet ai dhe, së fundi, nëse ekziston ndonjë mënyrë tjetër për arritjen e qëllimit të kufizimit me kufizime më të vogla të lirive dhe të drejtave. Kjo, siç shihet, ka të bëjë me **parimin e proporcionalitetit** dhe ka ngjashmëri të madhe në formulim me nenin 55 të **KKos**.

Regjimi i dytë apo i posaçëm i kufizimit, i cili, siç u tha, emërtohet si shmangie nga liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, gjithashtu ngjason shumë me zgjidhjet kushtetuese kosovare, mirëpo gjendet në pjesën e mbi kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë serbe. Në paragrafin e parë të nenit 202 të **KSerb**, lejohet shmangia nga liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, por vetëm në vëllimin që është i domosdoshëm. Masat e shmangies nuk guxojnë të bazohen në diskriminim në bazë të racës, gjinisë, gjuhës, fesë, përkatësisë nacionale ose prejardhjes sociale. Paragrafi i tretë përshkruan natyrën e përkohshme të shmangieve, përkatësisht deri të mbarojë gjendja e luftës ose gjendja e jashtëzakonshme. Në paragrafin e fundit përcaktohet në mënyrë të rreptë se cilat të drejta të garantuara nuk guxojnë të jenë objekt i shmangies, përkatësisht të drejtat e garantuara nga nenet 23 (dinjiteti dhe zhvillimi i lirë i personalitetit), 24 (e drejta për jetë), 25 (pacenueshmëria e integritetit fizik dhe psikik), 26 (ndalimi i skllavërisë, pozitës së ngjashme me skllavërinë dhe i punës së detyruar), 28 (sjellja ndaj

personit të privuar nga liria), 32 (e drejta për gjykim të drejtë), 37 (e drejta për subjektivitet juridik), 38 (e drejta për shtetësi), 43 (liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë), 45 (kundërshtimi i ndërgjegjes), 47 (liria e shprehjes së përkatësisë nacionale), 49 (ndalimi i shkaktimit të diskriminimit racor, nacional dhe fetar), 62 (e drejta për lidhjen e martesës dhe barazia e bashkëshortëve), 63 (liria e vendosjes për lindjet), 64 (të drejtat e fëmijëve) dhe 78 (ndalimi i asimilimit të dhunshëm) të **KSerb**. Edhe këtu, pra, bëhet fjalë për **liri dhe të drejta absolute** nga të cilat nuk mund të zbatohen masat e shmangies.

7.3. Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut në Kosovë

Bazat për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve gjenden në dispozitat kushtetuese që në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me mbrojtjen, si dhe në dispozitat mbi kompetencat e organeve shtetërore. **KKos** rregullon dhe siguron mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, si dhe përgjegjësinë dhe sanksionet për shkeljen apo cenimin e tyre. Ato janë bazë e rendit juridik në Kosovë, janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme (neni 21 parag. 1 dhe 2). Çdo kush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve (parag. 3 i nenit 21), të cilat vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme (paragrafi fundit i nenit 21). Edhe në nivel të qeverisjes lokale, kujdes i posaçëm i kushtohet komuniteteve jo shumicë: vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre (neni 123.4). Sa i përket mekanizmit mbrojtës, Kushtetuta njeh mbrojtjen gjyqësore, mbrojtjen pranë Gjykatës Kushtetuese dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve nga Avokati i Popullit.

Mbrojtja fillestare është pranë gjykatave: secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj (neni 32). Kjo nënkupton kthimin në gjendjen e mëparshme, të drejtën në largimin e pasojave të shkaktuara me shkeljen apo kufizimin e të drejtës ose lirisë konkrete. **KKos** nuk përmban garancion për qytetarët e vendit për të shfrytëzuar mekanizmat juridikë dhe gjyqësorë ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të tyre (GJEDNJ-ja dhe Komiteti i OKB-së).

Mbrojtja e drejtpërdrejtë e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve realizohet edhe pranë **Gjykatës Kushtetuese,** e cila është një organ shtetëror që ndër kompetencat e saj primare ka mbrojtjen e tyre (neni 113.7). Mjeti juridik me të cilin vihet në lëvizje procedura sipas nenit 113.7 është **ankesa kushtetuese**, një konstrukt juridik që nuk përmendet në **KKos**. Si i tillë, ky mjet mund të përdoret vetëm nëse janë shterur të gjitha mjetet juridike, apo nëse nuk ekziston një mjet efektiv juridik që mund të përdoret. Objekt goditjeje me ankesë kushtetuese është vendimi individual i një autoriteti publik, me të cilin cenohet liritë dhe të drejtat kushtetuese të garantuara.

Kompetencë themelore e **Avokatit të Popullit** është të mbikëqyrë dhe mbrojë të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike (nëni 132.1). Mbrojtja që ofron ky organ, megjithatë, nuk është juridike sepse vendimet e marra në vijim të mbikëqyrjes dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive njerëzore nuk kanë fuqi ekzekutive (nuk mund të ekzekutohen me dhunë).

Të drejtat dhe liritë personale - E drejta për dinjitet dhe zhvillim të lirshëm të personalitetit përbëjnë të drejtat dhe liritë fillestare personale të garantuara me **KKos**. Në fakt, sipas nenit 23, dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ai është marrëdhënie morale dhe e drejtë për respekt, i pacenueshëm dhe detyrë e secilit për respektim të tij. Ky detyrim në veçanti ka të bëjë me pushtetin, që prapa vetes ka aparatin e dhunës shtetërore. Çdo kush ka të drejtë për zhvillim të lirë të personalitetit të tij, sipas aftësive dhe dëshirave që ka, që nënkupton fitimin e përvojës dhe formimit, por në atë mënyrë që nuk cenon liritë dhe të drejtat e tjerëve.

Dinjiteti më së shpeshti cenohet me sulm ndaj integritetit fizik dhe psikik të individit, që sipas Kushtetutës duhet të respektohet nga të gjithë. Secili person gëzon të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të tij/saj, thotë neni 26 i **KKos**. Ky respektim përfshinë, në veçanti, këto forma:

1. të drejtën që të marrë vendime lidhur me reprodukimin, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me ligj;
2. të drejtën që të ketë kontroll mbi trupin e saj/tij në pajtim me ligjin;
3. të drejtën që të mos i nënshtrohet trajtimit mjekësor kundër vullnetit të tij/saj në pajtim me ligjin; dhe
4. të drejtën që të mos marrë pjesë në eksperimente mjekësore ose shkencore, pa pëlqimin paraprak të saj/tij.

Përveç si më sipër, sulmi ndaj integritetit fizik konsiston edhe në ushtrim të torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues, të gjitha këto veprime të ndaluara me **KKos** (neni 27). Këto veprime më së shpeshti ndodhin gjatë kohës së privimit të lirisë, në ndalim policor, paraburgim dhe burgim.

E drejta për jetën normohet me nenin 25 të **KKos** dhe ka karakter absolut. Jeta është e pacenueshme, që do të thotë se secili individ gëzon të drejtën për jetën. Forma kushtetuese e këtij karakteri absolut shprehet në mosekzistimin e dënimit me vdekje, sepse kjo e drejtë historikisht shikuar, më së shumti është cenuar nga shteti, i cili ka pasur monopolin mbi jetën dhe vdekjen e njeriut përgjatë historisë, në kohën më të madhe. Në mënyrë kategorike, paragrafi i dytë i nenit 25 thotë se dënimi me vdekje është i ndaluar, që nënkupton si në kohë paqeje ashtu edhe në kohë të luftës. Për dallim nga disa kushtetuta të vendeve fqinje, në **KKos** nuk ndalohet **klonimi** (krijimi i kopjes artificiale të kopjes identike të njeriut). As **eutanazia** e as **aborti** nuk përmenden në **KKos**, si dy mënyra të shkaktimit të vdekjes.

E drejta për jetën nënkupton edhe mbrojtjen përmes ndalesave kushtetuese, të cilat kanë të bëjnë me skllavërinë, pozitën e ngjashme me skllavërinë dhe punën e detyrueshme (neni 28). Askush nuk mund të mbahet në skllavëri ose në pozitë të ngjashme me skllavërinë (parag.1 i nenit 28). Pozitën e skllavit e kanë edhe personat që janë objekt i trafikimit me qenie njerëzore, gjë që përbën ndalesë kushtetuese: trafikimi i qenieve njerëzore është i ndaluar (parag. 3 i nenit 28). Puna e detyrueshme, që në thelb përbën materie juridike nga marrëdhëniet e punës, është ajo punë që kryhet me dhunën ose nën kërcënim të dhunës dhe, si e tillë, ndalohet me **KKos**. Këtu përfshihet edhe shfrytëzimi ekonomik ose seksual i njerëzve që janë në pozitë të palakmueshme. Këtë nuk e thotë Kushtetuta shprehimisht, por hyn në natyrën e kësaj ndalese. Kushtetuta e dallon punën e detyruar nga puna nga puna ose shërbimi i përcaktuar me ligj për personat e dënuar me vendim të formës së prerë gjatë vuajtjes së dënimit, as ajo që kryhet në raste të gjendjes së jashtëzakonshme, të shpallur sipas rregullave të përcaktuara me **KKos** (parag. 2 i nenit 28).

Liria personale në **KKos** garantohet me disa dispozita (nenet 29-30 & 35). Çdo kush ka të drejtë në liri dhe siguri personale (neni 29.1). Kjo do të thotë se individi mund të privohet nga liria (ndalim policor, paraburgim dhe burgim), vetëm për shkaqe dhe sipas procedurës së përcaktuar me ligj. Personit të privuar nga liria, **KKos** ia garanton një mori të drejtash procedurale-juridike me të cilat, nga njëra anë, mbrohet dinjiteti njerëzor dhe, së dyti, realizohet e drejta për mbrojtje, e cila konsiston në autorizimet për sa vijon: të informohet për arsyet e privimit nga liria në gjuhën që e kupton, për aktakuzën, të informojë personit sipas zgjedhjes së vet, të drejtën ankesës ndaj vendimit të gjyqit dhe vendosjes nga gjykata brenda një afati sa më të shkurtër, të drejtën që, nëse arresti ose ndalimi është i paligjshëm, të urdhërohet lirimi i personit (nenet 29 dhe 30). **KKos** nuk e thotë shprehimisht, por nënkuptohet, që mbrojtja e dinjitetit të personit të privuar nga liria është synim parësor i dispozitave të nenit 29 dhe 30. Me personin e tillë duhet të veprohet njerëzisht dhe në respektim të dinjitetit, gjë që përjashton përdorimin e dhunës për nxjerrjen e dëshmisë: në grupin e të drejtave minimale hyn e drejta e personit që të mos shtrëngohet

për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet (neni 30.6). **KKos** garanton të drejta të veçanta procedurale juridike për personin e privuar nga liria, siç janë e drejta për mbrojtësin dhe të drejtat tjera, dhe përcakton që ndalimi (policor) zgjat më së largu 48 orë, kurse paraburgimi nuk caktohet (për dallim nga disa kushtetuese të vendeve fqinje që caktojnë një periudhë të caktuar, kryesisht deri në gjashtë muaj). Paraburgimin e cakton gjykata e faktit në rastet kur gjyqtari konstaton se personi përbën rrezik për komunitetin ose ka rrezik për ikjen e saj/tij para gjykimit (neni 29.2). As këtu **KKos** nuk përcakton zgjatjet e paraburgimit, siç e bëjnë disa vende fqinje, por përdor shprehje më të pacaktuara: pjesa e parë e fjalisë së fundit të pagarg. 2 të nenit 29 thotë se "çdo kush që arrestohet, ka të drejtën që të nxirret në gjykim brenda një periudhe të arsyeshme, ose të lirohet në pritje të gjykimit".

Mbrojtja e lirisë personale në **procedurë gjyqësore** garantohet edhe përmes të drejtave të të akuzuarit (neni 30) dhe të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31). Gjykimi i drejtë është kur është gjykim publik, i zhvilluar pranë një gjykate të pavarur dhe të paanshme. Për të garantuar gjykimin e drejtë, me **KKos** garantohen domosdo disa të drejta të posaçme juridiko procedurale të të akuzuarit: lajmërimi mbi veprën me të cilën ngarkohet, e drejta për mbrojtës sipas zgjedhjes, e drejta e pjesëmarrjes në gjykim, e drejta e paraqitjes dhe propozimit të provave dhe marrjes në pyetje të dëshmitarëve, prezumimi i pafajësisë e drejta që çdo kush që është ndaluar ose arrestuar në kundërshtim me garancionet kushtetuese të kompensohet në mënyrën e parashikuar me ligj (neni 29.5 dhe nenet 30 dhe 31).

E drejta në barazi këtu ka rrënjët në të drejtën për mbrojtje të barabartë të të drejtave para gjykatave, organeve të tjera të pushtetit dhe bartësve të autorizimeve publike (siç janë, ta zëmë, institucionet dhe agjencitë e pavarura). E thënë ndryshe, e drejta për barazi është derivativ i të drejtës për mjete juridike në kuptimin e gjerë të fjalës. Në disa kushtetuta, e drejta për ankesë veçohet si e drejtë e posaçme, në ndërkohë që në Kosovë bëhet fjalë për mjete juridike në kuptim të të gjitha mjeteve ekzistuese dhe joekzistuese: Shteti duhet të garantojë mjete juridike efektive për qytetarët dhe subjektet tjerë të së drejtës për realizimin e të drejtave të tyre. Kjo është esenca e nenit 32 të **KKos**, që në nenin pararendës shpaloset kryesisht në kontekstin e procedurës penale. Kjo është kështu sepse, më së shpeshti, në procedurën penale vjen deri te cenimi i lirive dhe të njerëzore, shikuar historikisht. Për pasojë, ekziston nevoja që, siç bëjnë kushtetutat bashkëkohore, të përcaktohen garancione të qarta kushtetuese të natyrës penalo-juridike në dobi të të akuzuarit. Në këtë grup hyjnë edhe normat që garantojnë parimin e legalitetit të veprës penale dhe të sanksionit: parimi i retroaktivitetit garantohet vetëm nëse bëhet fjalë për ligj më të butë për kryesin e veprës (**lex mitior)** (neni 33.4). Një dispozitë shumë specifike kushtetuese në kontekst **të parimit të legalitetit** është ajo që ka të bëjë me moszbatimin e parimit të legalitetit të veprës dhe dënimit të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit. Kjo dispozitë është marrë thuajse **ad literam** nga neni 15.1 i PDCP-së. Po aq i rëndësishëm si garancion kushtetues me natyrë juridiko-procedurale është edhe parimi **ne bis in idem** (neni 34).

Liria e lëvizjes është një pjesë e pandashme dhe e rëndësishme e lirisë personale. Me **KKos**, kjo e drejtë ngërthen të drejtën e shtetasve të Kosovës dhe të huajve që të lëvizin lirisht në Republikën e Kosovës dhe të zgjedhin vendbanimin (neni 35.1). Kjo përfshinë të drejtën për të ikur nga vendi dhe për t'u kthyer sërish në të. Kjo e drejtë mund të kufizohet: sipas nenit 35.2 të **KKos**, arsyet për kufizim duhet të jenë të përcaktuara me ligj dhe vetëm nëse janë të nevojshme për procedurën ligjore, zbatimin e vendimit të gjykatës ose për të përmbushur obligimin për mbrojtjen e shtetit. Kur thuhet "të nevojshme për procedura ligjore", atëherë mendohet për ndalim policor dhe paraburgim, por jo edhe për burgim me vendim të formës së prerë: në rastin e fundit bëhet fjalë për privim nga liria, jo për kufizim të lirisë së lëvizjes. Shprehja "për të përmbushur obligimin për mbrojtjen e shtetit" nënkupton jo vetëm gjendjen e jashtëzakonshme për shkak të luftës ose rrezikut të drejtpërdrejtë nga lufta (masat emergjentë të mbrojtjes nga neni 131.1 nën 1), por edhe situatat nga neni 131.1 nën 2 (kur ka rrezik të brendshëm ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike) dhe 3 (kur ka fatkeqësi

natyrore, e cila prek tërë territorin e Republikës së Kosovës ose një pjesë të tij).

Liria e lëvizjes së të huajve në territorin e Kosovës është objekt i rregullimit të posaçëm ligjor, sipas autorizimit kushtetues nga neni 35.5 i **KKos**. I huaji mund të dëbohet nga vendi ynë vetëm me vendim të gjyqit, i dhënë në një procedurë të rregulluar ligjërisht. Ky dëbim mund të bëhet vetëm për në shtetin ku nuk ka rrezik serioz për cenim të të drejtave të garantuara me Kushtetutë apo përndjekja për shkak të racës, gjinisë, fesë dhe besimit, nacionalitetit, shtetësisë, përkatësisë në ndonjë grup shoqëror apo për shkak të mendimit politik.

Liria e mendimit në **KKos** fare nuk normohet si e drejtë e veçantë, siç e bëjnë disa kushtetuta të vendeve fqinje, por edhe marrëveshjet e instrumentet ndërkombëtare, në të cilat liria e mendimit normohet së bashku me lirinë e besimit, ndërgjegjes dhe fesë. Me 38 të **KKos** normohet **liria e besimit, ndërgjegjes dhe fesë**. Me këto liri, përfshirë lirinë e mendimit, mbrohet integriteti i brendshëm, shpirtëror, i personalitetit. Në paragrafin e parë të nenit 38 garantohet liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë. Ky garantim ngërthen të drejtën për të pranuar dhe për ta manifestuar fenë, të drejtën për të shfaqur bindjet personale dhe të drejtën për të pranuar ose refuzuar për të qenë anëtar i një bashkësie ose grupi fetar (paragrafi i dytë i nenit të njëjtë. Ndërgjegjja këtu nënkupton gjykimin moral të një individi lidhur me botën e jashtme, kurse besimi është bindja personale mbi diçka dhe dikë. Kushtetuta fenë dhe bindjet tjera i konsiderohen si çështje private të individit, për çka nuk ekziston detyrimit për deklarim: askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohet, në kundërshtim me ndërgjegjen e vet, që të marrë pjesë në praktikimin e fesë si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij/saj (neni 38.3).

Manifestimi i bindjeve fetare dhe besimeve të tjera mund të kufizohet me ligj, por vetëm nëse një gjë e tillë është e domosdoshme në një shoqëri demokratike. Arsyet për kufizim të kësaj lirie kanë të bëjnë me: mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve, lirive dhe të drejtave kushtetuese të qytetarëve, rendit dhe sigurisë publike (neni 38.4). **KKos** nuk e thotë, por këtu hyjnë edhe mbrojtja e shëndetit të njerëzve si dhe me qëllim të pengimit të shkaktimit apo nxitjes së urrejtjes fetare, nacionale. Gjithashtu, **KKos** nuk e thotë, siç e thonë marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare si dhe disa kushtetuta të vendeve fqinje, se liria e fesë përfshinë të drejtën e prindërve që, në pajtim me bindjet që vetë i kanë, t'u sigurojnë fëmijëve të tyre edukim fetar dhe moral. Përveç kësaj, e drejta e besimeve fetare dhe besimeve të tjera i jep të drejtë çdo kujt që të thirret në ndërgjegjen e vet për të kundërshtuar përmbushjen e detyrimeve ushtarake dhe detyrimeve të tjera që përfshijnë përdorimin e bartjes dhe përdorimit të armëve të zjarrit. Në një rast të tillë, në disa vende fqinje me Kosovën që kanë shërbimin e detyrueshëm ushtarak, ky shërbim kryhet pa armë, gjë që është sipas standardeve ndërkombëtare.

E lidhur ngushtë me **lirinë e besimit, ndërgjegjes dhe fesë** është materia e rregullimit kushtetues të pozitës së **konfesioneve fetare** (neni 39). Kosova definohet si shtet laik dhe neutral në çështjet fetare (neni 8), që nënkupton se bashkësitë fetare janë të ndara nga shteti, në të cilin asnjë fe nuk mund të jetë fe shtetërore apo e detyrueshme. Kjo nuk do të thotë se shteti nuk ka asnjë detyrim kundrejt bashkësive fetare: Republika e Kosovës siguron dhe mbron autonominë dhe monumentet fetare brenda territorit të saj, thotë neni 39.1 i **KKos**. Kjo nënkupton që konfesionet fetare janë të lira që të rregullojnë pavarësisht organizimin e vet të brendshëm, veprimtaritë fetare, si dhe ritet fetare (neni 39.2). Këta dy paragrafë janë shtylla e sigurimit të barazisë së konfesioneve fetare në vend. Paragrafi i fundit i nenit 39, normon tutje të drejtën e konfesioneve fetare që të themelojnë shkolla fetare dhe institucione bamirëse në pajtim me Kushtetutë dhe ligj. Në **Kosovë**, për dallim nga disa vende fqinje, nuk parashikohet e drejta e Gjykatës Kushtetuese për të ndaluar veprimtarinë e konfesioneve fetare kur ato nuk veprojnë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin.

Liria e shprehjes, me **KKos** garantohet si një e drejtë themelore personale (neni 40.1). Nuk do mend që ajo është edhe një e drejtë themelore politike, kur me të shprehen bindje dhe ide politike,

përkundër që kështu nuk e thotë Kushtetuta. Liria e shprehjes është në funksion të shprehjes së mendimit dhe atë për sa vijon: me gojë, me shkrim, në mënyrë pamore ose në ndonjë mënyrë tjetër. Me shprehjen e mendimeve shprehen, pranohen dhe barten informatat dhe idetë. Kjo duhet të bëhet pa u penguar nga askush, thotë fjalia e dytë e nenit 40.1 të **KKos**: Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush. Kjo liri mund të kufizohet me ligj, sipas autorizimit shprehimor kushtetues nga neni 40.2. Në fakt, kjo dispozitë e këtij neni përcakton jo vetëm autorizimin ligjor, por edhe arsyet për një kufizim të tillë: përveç që duhet të jetë kufizimi i përcaktuar në ligj dhe i domosdoshëm në një shoqëri demokratike, kufizimi vjen në shprehje në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.

Liria e shprehjes përfshinë edhe lirinë posaçërisht të garantuar nga neni 57.2 i **KKos**, sipas së cilës çdo pjesëtar i komunitetit do të ketë të drejtën që të zgjedhë lirisht nëse do të trajtohet ose të mos trajtohet si pjesëtar i komunitetit dhe nga kjo zgjedhje ose nga ushtrimi i të drejtave që ndërlidhen me këtë zgjedhje, të zgjedhë lirisht nëse do të trajtohet ose të mos trajtohet si pjesëtar i komunitetit dhe nga kjo zgjedhje ose nga ushtrimi i të drejtave që ndërlidhen me këtë zgjedhje. Kjo zgjedhje nuk mund të rezultojë në asnjë diskriminim (neni 57.2, pjesa e fundit e fjalisë). Liria e shprehjes është bazë edhe e disa lirive të thera, siç janë liria e artit dhe shkencës (neni 48), që nënkupton gëzimin e lirisë së mendimit dhe shprehjes, përkundër që këto më parë futen në liritë dhe të drejtat kulturore.

Me **KKos** garantohen të drejtat personale, që tradicionalisht cilësohen si të **drejta të privatësisë**. E para në mesin e tyre është e drejta në pacenueshmërinë e banesës (neni 36.1). Askush pa vendim me shkrim të gjyqit nuk mund të hyn në banesën e tjetrit apo në hapësira të tjera private, kundër vullnetit të mbajtësit të tyre (personat në posedim), as që mund të kryej bastisje (neni 36.2). Nëse ekziston urdhri për bastisje, mbajtësi i banesës apo hapësirës tjetër private ka të dejtë të jetë prezent vetë, apo përmes përfaqësuesit, së bashku me dy dëshmitarë të moshës madhore. Prezenca **in personam** e mbajtësit (apo përmes përfaqësuesit) dhe e dy dëshmitarëve, me rastin e bastisjes, nuk përcaktohet shprehimisht me **KKos** por përbën një standard të vendeve demokratike që është gjerësisht i përqafuar. Shmangia nga kjo rregull lejohet, nëse është e domosdoshme për arrestim të ligjshëm, për mbledhjen e provave që ka rrezik të humbasin ose për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për njerëzit dhe për pasuri, në mënyrën e përcaktuar me ligj. Gjykata duhet që t'i miratojë veprimet e tilla në mënyrë retroaktive (neni 36.2).

Në kategorinë e të drejtave të privatësisë, **fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera** merr një vend të posaçëm (neni 36.1). Me këtë mbrohet privatësia e personalitetit. Si e tillë, kjo e drejtë definohet si një e drejt që nuk mund të cenohet, pra si garancion kushtetues, por me natyrë relative. Kjo natyrë relative përcaktohet me **KKos**, në të cilën thuhet se kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm përkohësisht, në bazë të vendimit gjyqësor, nëse është e domosdoshme për ecurinë e procedurës penale ose për mbrojtjen e vendit, në mënyrën e parashikuar me ligj (neni 36.2). Në kategorinë e të drejtave të privatësisë hyn edhe **mbrojtja e të dhënave personale**: secili person gëzon të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale; mbledhja, ruajtja, qasja, korrigjimi dhe shfrytëzimi i tyre rregullohet me ligj (neni 36.4). Kushtetuta është e heshtur sa i përket përgjegjësisë për përdorimin e këtyre të dhënave për qëllime të tjera prej atyre për të cilat janë mbledhur, siç e bëjnë disa kushtetuta të vendeve fqinje. Si një standard ndërkombëtar, ekziston një parim sipas të cilit të dhënat mund të përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë mbledhur. Jo rrallë, kushtetutat, përfshirë vendet fqinje me Kosovën, përcaktojnë si vepër të dënueshme çdo përdorim të të dhënave jashtë qëllimit për të cilin janë mbledhur. Të dhënat që mblidhen për nevojat e zhvillimit të procedurës penale apo mbrojtjes së sigurisë së shtetit nuk gëzojnë këtë mbrojtje, por mund të përdoren, me vendim të gjyqit dhe atë vetëm përkohësisht. Të dhënat personale janë të pandara nga vetë personaliteti i njeriut dhe, për pasojë, çdo person ka të drejtë të jetë i informuar mbi secilën të dhënë për të dhe rreth tij dhe ka të drejtë për mbrojtjen e tyre me rrugë gjyqësore, nëse ato keqpërdoren nga poseduesi i tyre.

Martesa dhe familja janë pjesë e privatësisë së personit. E drejta publike vetëm pjesërisht normon këto institute të së drejtës familjare. **KKos** mbron familjen dhe martesën, duke i dhënë kësaj mbrojtjeje fuqinë më të lartë juridike: familja gëzon mbrojtje të veçantë të shtetit, thotë pjesa e parë e fjalisë së nenit neni 37.3.

Në paragrafin e parë të nenit 37 të **KKos** thuhet se çdo kush gëzon të drejtën të martohet dhe të drejtën që të krijojë familje në pajtim me ligjin. Për lidhje të martesës (dhe ndërprerje të saj) kërkohet një formë e caktuar, që nënkupton se kjo e drejtë nuk është absolute sepse realizimi i saj përfundimisht bëhet me vendim të një organi shtetëror (ofiqaria për lidhje dhe gjykata për shkurorëzim). Bashkëshortët janë të barabartë në rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet veti, brenda kufijve ligjorë (neni 37.2). Bashkësia jashtëmartesore është e barazuar me martesën, ani se kjo nuk thuhet shprehimisht në **KKos**, siç do të duhej. Kjo barazi vërehet qartë nëse kihen parasysh dispozitat tjera kushtetuese që garantojnë barazinë e fëmijëve martesorë me fëmijët jashtëmartesorë, në secilin aspekt, siç janë: e drejta e mbrojtjes dhe kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre; e drejta për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi; e drejta për raporte të rregullta personale dhe kontakte të drejtpërdrejta me prindërit e vet, me përjashtim kur institucioni kompetent përcakton se një gjë e tillë është në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës (neni 50).

Nisur nga fakti se **familja** gëzon mbrojtje të veçantë të shtetit, në pajtim me ligjin, kjo përfshinë edhe prindërit e divorcuar dhe fëmijët. Sipas rregullit, pikërisht për këtë arsye, **KKos** është dashur të garantojë edhe një pozitë të posaçme të nënës, para dhe pas lindjes, si dhe të garantojë të drejta të posaçme të fëmijëve, siç janë: e drejta në emër personal, në regjistrim në librin amëz të të lindurve, në prejardhje, në ruajtje të identitetit, në të drejta të posaçme të fëmijëve pa përkujdesje dhe të fëmijeve me ngecje në zhvillim. Nga të drejtat e posaçme të fëmijëve, **KKos** ka garantuar vetëm të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe ekspolatimi dhe barazinë e fëmijëve të lindur në martesë me fëmijët e lindur jashtë martese. Gjithashtu, **KKos** nuk ka përcaktuar, siç e bëjnë disa kushtetuta të vendeve fqinje, që është standard ndërkombëtar, aftësinë e veprimit të fëmijëve: deri në moshën pesëmbëdhjetëvjeçare ata nuk gëzojnë aftësinë e tillë, nuk mund të punësohen dhe deri në moshën madhore nuk mund të punojnë në punë të dëmshme për shëndetin apo moralin e tyre. Të drejtat prindërore mund të kufizohen me vendim të posaçëm të institucionit kompetent, nëse një gjë e tillë është në interesin më të mirë të fëmijës (neni 50.5).

Të drejtat dhe liritë politike - KKos përcakton konditat për të drejtën politike fillestare – **të drejtën zgjedhore**. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetëvjeçare, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, thuhet në nenin 45.1 të Kushtetutës. Nga ky redaktim i kësaj dispozite kushtetuese del se duhet të plotësohen dy kushte për një gjë të tillë: e para, mosha madhore (18 vjeçare); dhe, e dyta, shtetësia. Kjo ka të bëjë si me të **drejtën aktive zgjedhore** (të drejtën për të zgjedhë) ashtu edhe me të **drejtën pasive zgjedhore** (të drejtën për t'u zgjedhur) dhe vlen për të gjitha nivelet e zgjedhjeve. Kushtetuta nuk e përmend kushtin e vendbanimit në territorin e Kosovës, si kusht të katërt.

E drejta zgjedhore, pra, është një e drejtë përgjithshme për çdo shtetas të Kosovës. Në të njëjtën kohë, kjo e drejtë është e barabartë: çdo kush ka vetëm një votë. Votimet janë të lira dhe të drejtpërdrejta, kurse votimi është i fshehtë dhe i lirë (neni 45.2). Kushtetuta nuk thotë, por ekzistojnë përjashtimet ligjore nga votimi personal. Kjo e drejtë gëzon mbrojtjen juridike para Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), organit kuazi-gjyqësor për ankesa dhe parashtresa, Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Kushtetuese.

Lirinë e shtypit, KKos e cilëson si **liria e medieve** (neni 42), që është shprehje më e saktë dhe më bashkëkohore sepse nuk përfshinë normimin vetëm të lirisë së shtypit por edhe të mjeteve të tjetra të informimit. Çdo kush është i lirë të themelojë gazetë dhe mjetet të tjera të informimit publik, në mënyrën e përcaktuar me ligj, **pa leje të posaçme** (**sistemi i paraqitjes**). Kjo kështu nuk thuhet shprehimisht në

KKos, por natyrshëm rrjedh si pasojë e formulimit të paragrafit të parë të nenit 42 që thotë: "Garantohet liria dhe pluralizmi i medieve". **Televizionet** dhe **radiostacionet**, ndërkaq, themelohen sipas ligjit. Këto mediume elektronike shfrytëzojnë frekuencat e caktuara që konsiderohen resurse në pronësi të shtetit. Për pasojë, këto mediume janë nën regjim tjetër juridik me rastin e themelimit (**sistemi i lejes**).
Në Kosovë nuk ka **censurë**, si masë preventive ose represive e organeve të pushtetit, me të cilën kufizohet ose suspendohet liria e shtypit. Censura është e ndaluar, thuhet në fjalinë e parë të paragrafit të dytë të nenit 42 të **KKos**. Askush nuk mund të pengojë shpërndarjen e informacionit ose të ideve nëpërmjet medieve, vazhdon tutje fjalia e dytë e paragrafit të njëjtë, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare. Kjo dispozitë kushtetuese modelohet sipas standardit të **KEDNJ-së** që normon lirinë e medies.

Liria e medies është shumë e përshtatshme për cenimin dhe rrezikimin e lirive dhe të drejtave të të tjerëve, në veçanti të drejtës për dinjitet por edhe të drejtave e lirive të tjera, përmes paraqitjes së informatave të pasakta, jo të vërteta dhe jo të plota. Personi interesi i të cilit është cenuar, liria dhe e drejta e të cilit është shkelur, përmes paraqitjes së të dhënave dhe informatave të pasakta, jo të plota dhe jo të vërteta, ka të drejtë në përmirësim të informatës dhe të dhënave të paraqitura kësisoj, përfshirë dhënien e përgjigje në informatë, demantimi, në pajtim me ligjin. Kjo qartësisht sanksionohet me nenin 42.3 të **KKos** që thotë se "Çdo kush ka të drejtë të korrigjojë informacionin e pavërtetë, jo të plotë ose të pasaktë të publikuar, nëse cenon të drejtat ose interesat e saj/tij, në pajtim me ligjin".

Si pjesë e lirisë së medies është edhe detyrimi për informim, përkundër që në **KKos** nuk përcaktohet si i tillë. Ky detyrim nënkuptohet dhe rrjedh nga fryma e nenit 42 dhe konsiston në të drejtën e secilit për të qenë i informuar në tërësi dhe me kohë lidhur me çështjet që kanë rëndësi publike. Në fakt, ky nen duhet të lexohet në lidhje me nenin pararendës, nenin 41, që rregullon të drejtën kushtetuese për qasje në dokumente publike. Kjo nënkupton se çdo kush, në pajtim me ligjin që nxirret sipas autorizimit kushtetues nga neni 41.2., ka të drejtë në qasje në informata që kanë rëndësi publike – të dhëna që i kanë organet shtetërore apo organizatat që ushtrojnë autorizime publike. Formulimi i paragrafit të dytë të nenit 41 është pak më ndryshe, por ka këtë kuptim: "Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë" (neni 41.2).

Liria e organizimit politik, sindikal dhe e çdo formë tjetër të asociimit garantohet me nenin 44 të **KKos**, që mban titullin "Liria e Asociimit". Kjo e drejtë përfshinë të drejtën për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate (neni 44.1.). Për themelimin e partisë politike dhe shoqatave të tjera nuk nevojitet leje paraprake e organeve të pushtetit, por me paraqitjen e saj partia ose shoqata regjistrohet në regjistrin që e mban organi shtetëror në pajtim me ligjin. Ky është kuptimi i dispozitës kushtetuese nga neni 44.1 që definon lirinë e asociimit si një të drejtë të secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje. Pra bëhet fjalë për leje nga organi shtetëror, e cila nuk kërkohet. Në mënyrë të posaçme garantohet liria e organizimit sindikal dhe organizimit tjetër, me qëllim që të mbrohen interesat (neni 44.2). Me ligj kjo liri mund të kufizohet për kategori të caktuara të punonjësve, siç janë: gjyqtarët, gjyqtarët kushtetues, prokurorët, ushtarakët etj. Këtu përfshihet edhe ndalesa për të qenë anëtar të partive politike. Gjykata Kushtetuese nuk ka jurisdiksion ndaj kushtetutshmërisë së veprimtarisë dhe punës së organizatave dhe shoqatave të themeluara sipas nenit 44 të **KKos**. Organizatat ose aktivitetet që kanë për qëllim cenimin e rendit kushtetues, shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut, ose nxitjen e urrejtjes racore, kombëtare, etnike a fetare, mund të ndalohen me vendim gjyqësor të gjykatës kompetente (neni 44.3). Me gjykatë kompetente nënkuptohet një gjykatë e rregullt, jo Gjykata Kushtetuese.

Në të drejta të garantuara politike konsiderohen **liria e tubimit**, **liria e pjesëmarrjes në punët publike** dhe **e drejta në peticion**. E para, liria e tubimit sanksionohet me një nen të veçantë dhe me titull

të veçantë të **KKos** – nenin 43 ("Liria e Tubimit"). E dyta, liria e pjesëmarrjes nuk ka nen të veçantë por normohet me paragrafin e fundit të nenit 45 ("Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes"), që përcakton si vijon: "Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike". Së fundi, **e drejta për peticion** nuk parashihet si një e drejtë e posaçme politike.

Liria e tubimit paqësor është e garantuar, thuhet në fjalinë e parë të nenit 43 të **KKos**. Ekziston dallimi në mes të tubimit në hapësira të mbyllura dhe tubimit në hapësira të hapura, dallim që buron nga ndërtimi i dispozitës kushtetuese të shprehur në fjalinë e dytë të nenit të njëjtë, ku thuhet: "Secili person gëzon të drejtën për të organizuar tubime, protesta dhe demonstrata, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në to". Tubimi në hapësirë të mbyllur, private ose publike, nuk i nënshtrohet lejes. Në këto raste, tubimi as që duhet të lajmërohet te organet e pushtetit. Protestat dhe demonstratat, si dhe tubimet tjera ë hapësirë të hapur lajmërohen te organi shtetëror, në pajtim me ligjin. Këtë nuk e thot shprehimisht dispozita e nenit 43 si më sipër, por nënkuptohet nga redaktimi i fjalisë së dytë të nenit në fjalë. Ndryshe nuk ka kuptim dallimi në mes të tubimit në hapësirë të hapur dhe tubimit në hapësirë të mbyllur. Përndryshe, tubimi në cilëndo hapësirë mund të kufizohet, sipas autorizimit shprehimor kushtetues nga fjalia e fundit e nenit 43, në të cilin përcaktohet shkaqet për një kufizim të tillë: "Këto të drejta mund të kufizohen me ligj, nëse është e domosdoshme për të siguruar rendin publik, shëndetin publik, sigurinë kombëtare, ose mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve".

Liria e pjesëmarrjes në punët publike, në kuptim të paragrafit të fundit të nenit 45 të **KKos**, garantohet për të gjithë qytetarët. Kjo nënkupton se, në kushte të barabarta, të gjithë qytetarët kanë të drejtë të hyjnë në shërbim publik dhe funksione shtetërore. Kjo dispozitë përmend të gjithë qytetarët, pra nuk përcakton nëse duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës. Nga vendi i kësaj dispozite, si dhe nga natyra e pjesës dërrmuese të shërbimeve publike dhe funksioneve shtetërore, qartë dihet që bëhet fjalë për qytetarë që janë shtetas dhe barazia matet vetëm në mes të qytetarëve shtetas, jo në mes të qytetarëve që nuk janë shtetas të Kosovës dhe shtetasve kosovarë.

Sikundër u tha, **e drejta në peticion** nuk garantohet me **KKos**. Kjo nënkupton të drejtën që vet ose me të tjerët të dërgojë propozime organeve qendrore dhe lokale dhe autoriteteve të tjera publike, me qëllim të marrjes së përgjigje për to. Kjo nënkupton se, e drejta e peticionit nuk është e drejtë për miratim të propozimit, por të drejtën për t'u dëgjuar nga ana e autoriteteve shtetërore dhe autoriteteve të tjera publike. Gjithashtu, e drejta e peticionit dhe shprehjes së pikëpamjeve në peticion nuk tërheqin pasoja të dëmshme për propozuesin e peticionit, përveç nëse me të bëhet kryerja e një vepre penale (ta zëmë, thirrja për kryengritje të armatosur).

Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore.- KKos garanton të **drejtën e punës** (neni 49.1). Brenda kësaj të drejte themelore ekonomike ekzistojnë disa garancione të tjera, liri dhe të drejta lidhur me punën, të cilat përmblidhen në paragrafin e dytë të nenit 49, që përcakton si vijon: "Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës" (neni 49.2). Me këtë çdo kujt i garantohet zgjedhja e lirë e punës dhe qasja e vendeve të punës në kushte të barabarta. Kjo është krejtësisht e ndryshme nga e drejta për punë, me kuptim të drejtën e çdokujt për të pasur punë medoemos. Esenca e kësaj të drejte lidhet me të drejtat nga procesi punës. Në këtë kuptim, çdo kush ka të drejtën për respektim të dinjitetit në punë, në kushte të sigurta dhe të shëndetshme të punës, mbrojtjen e domosdoshme në punë dhe kohën e kufizuar të punës. Çdo kush ka të drejtën për pushim ditor dhe javor nga procesi i punës (nga puna), pushim vjetor me pagesë, kompensim të drejtë për punë – rrogën dhe mbrojtjen juridike në rast të ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Të punësuarit nuk mund të heqin dorë nga këto të drejta e as ato nuk mund të merren apo kufizohen, sepse janë derivat i garancionit kushtetues mbi të drejtën e punës dhe ushtrimin e profesionit nga neni 49 i **KKos**.

Nga statusi i personit të punësuar burojnë edhe disa të **drejta sociale** për vetë të punësuarin dhe familjen e tij, siç janë: e drejta për kompensim të fitimit në rast të papunësisë së përkohshme, e drejta në sigurimin shëndetësor dhe social të anëtarëve të familjes, në veçanti e drejta në pension familjar. Si kujdesi shëndetësor ashtu edhe sigurimi social rregullohen me ligj (neni 51.1), siç rregullohen me ligj edhe sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë (neni 51.2). Jo rrallë, në kushtetuta, përfshirë disa prej vendeve fqinje me vendin tonë, por jo edhe vetë vendin tonë, përcaktohen kushte të posaçme dhe mbrojtje e veçantë për gratë, të miturit dhe të rinjtë. Edhe këto garancione, më pas, në mënyrë të detajuar normohen me ligj.

Çuditërisht, **KKos** nuk garanton **të drejtën për grevë**, përkundër që normon lirinë e **organizimit sindikal**. Kjo e drejtë është shumë e rëndësishme dhe garantohet me akte relevante ndërkombëtare dhe regjionale, si dhe me shumë kushtetuta nacionale, përfshirë edhe disa prej vendeve fqinje me Kosovën. Aty ku garantohet me kushtetutë nacionale, kjo e drejtë më pastaj në detaje normohet me ligj dhe marrëveshje kolektive. Me këto të fundit, që lidhen në mes të të punësuarve, përkatësisht sindikatave të tyre dhe punëdhënësve, zgjerohen të drejtat lidhur me punën që garantohen me kushtetutë dhe ligje nacionale. Realizimi i të **drejtës për grevë** kufizohet vetëm në bazë të ligjit, konform natyrës dhe llojit të veprimtarisë. Në mesin e këtyre veprimtarive, vlen të përmenden: shëndetësia, arsimi, ekonomia ujore, puna në organin shtetëror, komunikacioni, komunikimi postar, veprimtaritë komunale dhe veprimtaritë tjera me interes publik apo veprimtaritë ndërprerja e të cilave mund të rrezikojë jetën dhe shëndetin e njerëzve apo të shkaktojë dëm të përmasave të mëdha. Gjatë **grevës** duhet të sigurohet procesi minimal i punës. Pjesëtarët e **ushtrisë** nuk kanë të drejtë në grevë, kurse ata të policisë nuk e gëzojnë këtë të drejtë në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme (kur dhunshëm rrezikohet rendi kushtetues, ekzistojnë lufta ose rreziku i drejtpërdrejtë nga lufta dhe fatkeqësia natyrore). Këto standarde, që nuk i garanton **Kushtetuta e Kosovës**, gjenden të sanksionuara në instrumentet kryesore ndërkombëtare dhe evropiane, prandaj edhe i shpërfaqëm këtu përciptazi për lexuesit tanë.

KKos nuk garanton shprehimisht as **të drejtën e ndërmarrësisë**, siç e bëjnë kushtetutat e disa vendeve fqinje, përkundër që në mënyrë të veçantë flet për pluralizëm ekonomik dhe të pronës, përkatësisht për marrëdhënie ekonomike të bazuara në tregun e lirë, lirinë e aktivitetit ekonomik dhe sigurinë e pronës publike e private (neni 119.1). Kjo nënkupton se **e drejta e ndërmarrësisë** mund të nxirret si një e drejtë kushtetuese në kuadër të normimit nga kapitulli IX i Kushtetutës, që ka të bëjë me marrëdhëniet ekonomike. Aty, subjekteve ekonomik, të vendit dhe të huaj, iu garantohet liria dhe siguria e punës dhe fitimit. Ndërmarrësia është e lirë, bazuar në dispozitat e këtij kapitulli, që nënkupton se çdo kush mund të merret me biznes apo ndërmarrësi private, kurse kjo e drejtë kufizohet vetëm me ligj me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve, mjedisit jetësor dhe pasurive natyrore si dhe sigurisë së shtetit. Edhe këto kufizime, njëjtë si **e drejta e ndërmarrësisë**, mund të nxirren nga dispozitat kushtetuese të kapitullit IX, të cilat përcaktojnë autorizime për ligjvënësin kosovarë për rregullim të marrëdhënieve ekonomike, financave publike, pronës, përdorimit të pasurisë dhe burimeve natyrore (nenet 119-122).

Në një nen të vetëm garantohet e **drejta e pronës** (neni 46). Që në titull shihet qartë se bëhet fjalë për një dispozitë kushtetuese defektuoze, sepse pronësia është vetëm njëra prej të drejtave pasurore, të cilat në shumë kushtetuta në vendet demokratike garantohen si të tilla, pra si grup i të drejtave. Ndër ne, siç shihet nga kjo dispozitë, nga të drejtat pasurore, vetëm e drejta pronësore ka gjetur vendin në tekstin e KKos. Edhe në vendet fqinje bëhet dallimi në mes të drejtave pasurore si garancione kushtetuese dhe të drejtës pronësore, si njëri prej garancioneve lidhur me të drejtat pasurore. E drejta e pronës, sido që të jetë, paraqet një të drejtë që ka natyrë të komplikuar. Ajo është një e drejtë personale, sepse lidhet për personin fizik ose juridik. Është e drejtë ekonomike, sepse krijon dobi për shfrytëzuesin e saj. Si një e drejtë politike, e drejta e pronës shërben si themel i rregullimit kushtetues dhe politik të bashkësisë së dhënë politike (nga forma e pronës diktohet edhe natyra e regjimit kushtetues dhe politik në një masë të madhe). E drejta e pronës garantohet që në paragrafin e parë të nenit 46 të **KKos**. Kjo e drejtë nuk bën pjesë në grupin e **të drejtave absolute**, përkundër që në kulturën kushtetuese perëndimore konsiderohet

si **një e drejtë e shenjtë**. E drejta pronësore mund të merret dhe mund të kufizohet, gjë që nënkupton se me kushtetutë, kjo e drejtë mund të cungohet në dy prej atributeve kryesore të dimensioneve të pronësisë: disponimi dhe shfrytëzimi me pronën. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik, na thotë paragrafi i dytë nenit 46 të **KKos**. Fjalë kyçe këtu është interesi publik, do të thotë se normimi i pronës, si marrëdhënie që ka atributet e saj (e drejta e përdorimit, shfrytëzimit dhe disponimit), çdo herë ka parasysh një interes publik. U mor vesh, në shoqëritë demokratike garancioni i të drejtës për pronë dhe të drejtave të tjera pasurore shoqërohet me garancione të forta kushtetuese sa i përket privimit të së drejtës pronësore dhe të drejtave të tjera pasurore. Si parim themelor i këtij garancioni prezent në të gjitha shoqëritë perëndimore është se privimi nga e drejta pronësore dhe çdo e drejtë tjetër pasurore nuk guxon dhe nuk mund të jetë arbitrar: askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona thotë me tone urdhëruese fjalia e parë e paragrafit të tretë të nenit 46 si më sipër të **KKos.** Por, çfarë nëse, përmes gojës së ligjit, vije deri te shfaqja e nevojës së domosdoshme publike për ndërhyrje në ndonjërën prej atributeve të pronës, qoftë duke privuar titullarin e saj ose duke e penguar atë në shfrytëzimin paqësor të atributeve pronësore? Kushtetutëbërësi kosovar, njëjtë siç e bëjnë edhe vendet përreth, ka garantuar se deri te privimi nga e drejta pronësore, ose deri te kufizimi i saj, mund të vije vetëm nëse ky interes publik është i definuar me ligj dhe bëhet kundrejt një kompensimi të menjëhershëm dhe adekuat të personit e drejta pronësore e të cilit merret ose kufizohet (neni 46 para. 3). Në paragrafin e katërt të këtij neni, gjykata kompetente autorizohet për zgjidhen e mosmarrëveshjeve rreth eksproprijimit (shpronësimit), kurse në të pestin normohet prona intelektuale. Ky nen, siç vërehet, përveç që ka defekte serioze në caqet e normimit të së drejtave pasurore, duke e kufizuar vetëm në të drejtën e pronësisë, është edhe i mangët për një arsye tjetër: nuk përcakton nëse mund të merret apo kufizohet pronësia me qëllim të pagimit të tatimit, kontributeve të tjera dhe dënimeve, siç e bëjnë disa kushtetuta të vendeve përreth. Ky nen është dashur ta autorizojë ligjvënësin kosovar për normim të privimeve dhe kufizimeve të të drejtave pasurore kur ato kanë të bëjnë me tatimin, kontributet tjera dhe dënimin. Kjo është edhe për faktin se neni 119.8 i **KKos**, qartë përcakton detyrimin e secilit person për të paguar tatimet dhe kontributet e tjera të parapara me ligj.

KKos normon një mori **të drejtash sociale**, që derivojnë natyrshëm nga preambula dhe dispozitat hyrëse të kushtetuese, në të cilat përmendet **drejtësia sociale**, frazë kjo e zakonshme në kushtetutat e vendeve ish-komuniste. Shteti që kultivon drejtësinë sociale nuk është i barasvlershëm me të qenët **shtet social**. Gjendja e fundit, që ekziston në disa vende, ta zëmë në **Gjermani**, nënkupton garancion kushtetues shprehimor në dobi të qytetarëve të vendit, sipas të cilit shteti qëndron aktivisht prapa tyre për realizimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore dhe kujdeset në mënyrë efektive për mirëqenien e tyre. Ndër ne, si dhe në vendet tjera ish-komuniste, të drejtat sociale, ekonomike dhe kulturore nuk janë vënë aty për të shërbyer si ndërtues të shtetit social por për të vënë në vend drejtësinë sociale për brenda mundësive dhe kapaciteteve shtetërore ekzistuese. Kjo është kështu edhe në rastin e Kosovës, preambula e së cilës flet për zotimin e kushtetutëbërësve për ndërtimin e Kosovës si **shtet të mirëqenies ekonomike dhe prosperitetit social.** Pra, siç shihet, bëhet fjalë për zotim. Në nenin e parë të pjesës operative të Kushtetutës, fare nuk përmendet kjo shprehje e as komponenta sociale nuk përmendet si njëri ndër elementet definuese të Republikës së Kosovës. Vetëm në nenin 7 të **KKos**, që sanksionon vlerat në të cilat bazohet rendi kushtetues, përdoret shprehja **drejtësi sociale**. Kjo dispozitë, për dallim nga disa prej dispozitave të tjera themelore kushtetuese, nuk përmban autorizim për ligjvënësin për të implementuar drejtësi sociale në mënyrë specifike, me synim krijimin e **shtetit social**. Redaktimi i kësaj dispozite, më shumë përfaqëson një shpalosje publike e vlera kushtetuese, të cilat i ka përzgjedhur kushtetutëbërësi kosovar, si një tregues i orientimit të përgjithshëm dhe i vetë fizionomisë së shtetit dhe pushtetit.

Në të **drejtat e para sociale**, dhe të vetmet, hyjnë ato që normohen me nenin 51 të **KKos** dhe që përfshijnë, në dy paragrafë, mbrojtjen shëndetësore dhe sociale. Në paragrafin e parë, vetëm thuhet se kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social rregullohen me ligj, kurse në të dytin normohet sigurimi social themelor. Ky lloj sigurimi, pra **sigurimi social themelor**, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, af-

tësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj. Sikundër shihet, në dy paragrafët dispozita kushtetuese është autorizuese, pa asnjë përmbajtje relevante për të garantuar të drejtat sociale që kanë të bëjnë me shëndetin dhe mbrojtjen sociale. E drejta për mbrojtjen e **shëndetit fizik dhe psikik** përbën një të drejtë themelore që e hasim të normuar ndërkombëtarisht dhe në nivel evropian, **inter alia**, në **DUDNJ** (neni 12), **PDESK** (neni 12), **KEDNJ** (neni 8) dhe KSE (neni 11). Esenca e kësaj të drejte themelore ekonomike, e cila haset në disa nga kushtetutat e vendeve fqinje, sipas standardeve ndërkombëtare dhe regjionale, konsiston në të drejtën për mbrojtje shëndetësore falas - prevencion dhe shërim me fondet publike, për kategoritë e caktuara të popullsisë, si vijon: fëmijët, gratë shtatzëna, nënat gjatë pushimit të lehonisë, prindërit e divorcuar me fëmijë deri në dhjetë vjet dhe personat në moshë. Krejt kjo duhet të përcaktohet me ligj. I vetmi kusht kushtetues është që personat e mësipërm mos të jenë përfitues i kësaj mbrojtjeje mbi ndonjë bazë tjetër. Sistemi shëndetësor, përkatësisht sigurimi, mbrojtja shëndetësore dhe fondet shëndetësore, u mor vesh, normohen me ligj. Ky normim kosovar në nenin 51, si më sipër, është i pamjaftueshëm, për arsye se shteti ka nevojë të ketë qytetarët të shëndetshëm dhe, mbi këtë bazë, lind edhe detyrimi i tij kushtetues për të ndihmuar zhvillimin e kulturës shëndetësore dhe fizike.

Në ndërkohë që paragrafi i parë i nenit 51 i **KKos** nuk thotë asgjë për mbrojtjen shëndetësore, pos që autorizon ligjvënësin për normim të kësaj materie kushtetuese, pa dhënë asnjë parametër apo standard relevant të prekshëm (material) që ofron garancione për qytetarët dhe mbrojtjen e tyre shëndetësore, **e drejta për mbrojtje sociale**, përkatësisht **e drejta për sigurimin social themelor** paraqitet me më shumë përmbajtje. Paragrafi dytë thotë se "sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj". Këtu, pra, siç shihet, **KKos** i vë detyrim ligjvënësit për rregullim të segmenteve të caktuara të sigurimit social themelor, përkundër që nuk i jep parametrat materialë të këtij normimi. Në këtë kuptim, parametri themelor konsiston në atë se **drejta për sigurim social** është një e drejtë që duhet të gëzohet nga qytetarët e familjet që kanë nevojë për ndihmë monetare dhe ndihmë tjetër nga ana e shtetit, për të plotësuar nevojat e tyre themelore jetësore në ushqim, veshmbathje, banim, ngrohje dhe në përballim të vështirësive të tjera sociale dhe jetësore. Kjo është kështu për shkak se, mbrojtja sociale bazohet në parimet e drejtësisë sociale, humanizmit dhe respektimit të dinjitetit njerëzor. Që të tria janë vlera kushtetuese. Për më tepër, dinjiteti njerëzor përbën faktorin definues të krejt lirive dhe të drejtave të garantuara në kapitujt dy dhe tre të KKos. Përkundër që këta parametra nuk janë vënë siç duhet në nenin 51 të Kushtetutës, ata mund të deduktohen nga dispozitat tjera kushtetuese, si dhe nga instrumentet e marrëveshjet ndërkombëtare që Kosova i ka konstitucionalizuar në nenin 22 të Kushtetutës. Ndryshe, dispozita e nenit 51 ngelet bosh dhe ekskluzivisht deklarative, me qëllim autorizimin e ligjvënësit për rregullim të kësaj materie, pa i ofruar atij asnjë parametër matës me rastin e rregullimit. Sidoqoftë, papunësia, sëmundja, aftësitë e kufizuara dhe mosha e shtyrë janë futur si parametra kushtetues të sigurimit social themelor. Sigurimi social i njerëzve të punësuar dhe familjeve të tyre përfaqëson një të drejtë sociale që rrjedh nga e drejta për punë, siç rrjedh edhe e drejta e kompensimit për papunësinë dhe pengesat e përkohshme për punë (pushimet shëndetësore). Krahas kësaj, me këtë nen ofrohet një garancion edhe për invalidët, pa specifikuar llojin e invalidëve, si dhe personat në moshë. Kjo e fundit, **e drejta për pension**, së bashku me të drejtat tjera sociale si më sipër nga paragrafi i dytë i nenit 51 të **KKos**, realizohet nga fondet sociale që formohen në pajtim me ligjin.

Me **KKos** garantohet **e drejta për arsimin** (neni 47). Këtë të drejtë e gëzon çdo kush, kurse në një pjesë të saj është e detyrueshme. Si e detyrueshme konsiderohet shkolla fillore, që nënkupton se prindërit kanë detyrë për të dërguar në shkollë fillore fëmijët e tyre. Dispozita e paragrafit të tyre të nenit 47 që përcakton se "institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t'u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj", duhet kuptuar se bëhet fjalë për shkollimin e lartë universitar në sektorin publik. Kjo dispozitë nënkupton, gjithashtu, që shteti ka detyrim ndaj studentëve të mirë por me gjendje të keqe materiale, të cilëve duhet t'u ofrojë studim pa pagesë, në pajtim me ligjin. Në disa kushtetuta të vendeve fqinje me Kosovën garantohet **autonomia e universitetit**, që nuk është rasti me Kosovën, si një garancion kushtetues në sferën e të drejtave kulturore.

Një e drejtë tjetër kulturore që normohet me **KKos** ka të bëjë me lirinë e artit dhe shkencës (neni 48). Me këtë nen garantohet liria e krijimtarisë artistike dhe shkencore (parag.1), si dhe liria akademike (neni 2). Kjo e fundit, pra, garantohet vetëm në nivel individual si një e drejtë kulturore, por jo edhe në planin institucional të lirisë akademike, shprehje e së cilës është autonomia e universitetit dhe e institucioneve të tjera akademike në sferat e artit dhe shkencës. Nuk thuhet në **KKos**, por vetëkuptohet se ky garancion i lirisë së artit dhe shkencës ngërthen një detyrim për shtetin për të nxitur dhe ndihmuar zhvillimin e shkencës, kulturës dhe artit. Kjo thuhet shprehimisht në disa prej kushtetutave të vendeve fqinje me **Kosovën**, të cilat garantojnë edhe të drejtat morale dhe materiale të autorëve të veprave të artit dhe shkencës. Sikundër u pa më sipër, në Kosovë, një gjë e tillë normohet në kuadër të së drejtës së pronës intelektuale, e cila, megjithatë, mbrohet me ligj, jo me Kushtetutë (neni 46.5).

Në kuadër të lirive dhe të drejtave të **gjeneratës së tretë**, **KKos** bën fjalë vetëm për njërën prej tyre. Në fakt, ajo as nuk e formulon si një liri ose të drejtë njerëzore, por si një përgjegjësi të posaçme. E kemi fjalën për **përgjegjësinë për mjedisin jetësor** nga neni 52 i Kushtetutës. Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin, thuhet në paragrafin e parë të këtij neni. Institucionet e pushtetit publik **angazhohen** për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton, konstatohet në paragrafin e dytë. Paragrafi i fundit tregon se ndikimi në mjedisin jetësor **merret parasysh** nga institucionet publike në procesin e marrjes së vendimeve. Siç shihet, kushtetutëbërësi në tri dispozitat kushtetuese ka përdorur shprehje e qasje të karakterit proklamativ dhe deklarativ. Për më tepër, në formulimin e dispozitës së paragrafit të tretë shihet qartë synimi i shtetit për të mënjanuar përgjegjësinë e tij dhe të institucioneve shtetërore për mjedisin, duke thënë vetëm se "ndikimi në mjedisin jetësor merret parasysh", pra nuk është detyrim kushtetues. Po të ishte detyrim kushtetues, nuk do të përdorej as shprehja "institucionet e pushtetit publik angazhohen", por shprehja e qartë urdhëruese që thotë se "institucionet e pushtetit publik detyrohen". Edhe konstatimi i paragrafit të parë se përgjegjësia për mjedisin është përgjegjësi e secilit, ka karakter deklarativ dhe shfajësues, siç kanë liritë dhe të drejtat e gjeneratës së tretë në të shumtën e rasteve. Kjo sepse, kushtetutëbërësi nuk ka treguar se si materializohet kjo përgjegjësi e secilit prej nesh dhe ndaj kujt ekziston përgjegjësia në fjalë.

7.3.1. Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri

Edhe në Shqipëri, bazat për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të pakicave gjenden në dispozitat e **KShq** që në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me mbrojtjen, si dhe në dispozitat mbi kompetencat e organeve shtetërore. **KShq** rregullon dhe siguron mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, si dhe përgjegjësinë dhe sanksionet për shkeljen apo cenimin e tyre. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik (neni 15 parag. 1). Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre (neni 15 parag. 2). Të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve (neni 16 parag. 2). Në nivel të qeverisjes lokale, për dallim nga Kosova, **KShq** nuk i kushton një kujdes pakicave kombëtare dhe as nuk normohen parimet e punës së qeverisjes vendore, që përbëjnë standard ndërkombëtar të **Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale** të vitit 1985 (KEVL), siç janë: vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre. Në vend të kësaj, **KShq**, kur flet për ndarjet administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore, thekson se ato "caktohen me ligj mbi bazën e nevojave e të interesave të përbashkët ekonomikë dhe të traditës historike". (neni 108 parag. 2).

Sa i përket mekanizmit mbrojtës së lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të pakicave, edhe **KShq** njeh mbrojtjen gjyqësore, mbrojtjen pranë **Gjykatës Kushtetuese** dhe mbrojtjen nga **Avokati i Popullit**. Mbrojtja fillestare është pranë gjykatave: "Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor" (neni 42 parag. 1). Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj (neni 42 parag. 2). Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës (neni 43). **KShq** nuk përmban dispozita shprehimore që kanë formë garancioni kushtetues për qytetarët e vendit, për të shfrytëzuar mekanizmat juridik dhe gjyqësor ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të tyre (**GJEDNJ-ja** dhe **Komiteti i OKB**-së). Mirëpo, marrë parasysh faktin se Shqipëria është anëtare e **KE-së** dhe **OKB-së** dhe, për pasojë, i **KEDNJ-së** dhe **PDCP-së**, atëherë nënkuptohet se ekziston e drejta e qytetarëve dhe subjekteve të tjerë të së drejtës shqiptare për t'iu drejtuar këtyre institucioneve ndërkombëtare dhe forumeve të tjera ku Shqipëria është anëtare si shtet sovran dhe i pavarur në kuptim e plotë të këtij koncepti.

Mbrojtja e drejtpërdrejtë e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve realizohet edhe pranë **Gjykatës Kushtetuese,** e cila vendos për "gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë" (neni 131 parag. 1 pika "f").

Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike (neni 60 parag.1). Mbrojtja që ofron ky organ, megjithatë, njëjtë si në Kosovë, nuk është juridike sepse vendimet e marra në vijim të mbrojtjes së të drejtave, lirive dhe interesave individuale nuk kanë fuqi ekzekutive (nuk mund të ekzekutohen me dhunë).

Sikundër shihet, konceptualisht, nuk ka asnjë dallim në mes të zgjidhjeve kushtetuese shqiptare dhe atyre të Kosovës, sa i përket mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut. I vetmi dallim me KKos është se **KShq** bën kategorizimin e lirive dhe të drejtave sipas gjeneratave dhe e bënë më të lehtë shfrytëzimin dhe interpretimin e tyre.

Të drejtat dhe liritë personale - Nenet 21 deri 44 të kreut të dytë **KShq** i kushtohen lirive dhe të drejtave personale, të cilat kushtetutëbërësi shqiptar i quan **liri dhe të drejta vetjake**. Ky kapitull nis me të **drejtën për jetë**, të cilën çuditërisht e garanton përmes ligjit: Jeta e personit mbrohet me ligj, thotë fjalia e vetme e nenit 21 të **KShq**. Sipas këtij redaktimi të kësaj dispozite del sikur me ligj mund të caktohet dënimi me vdekje dhe format tjera të marrjes së jetës së njeriut (lufta, gjendja e jashtëzakonshme në të gjitha trajtat e saj dhe kështu me radhë). Kjo, megjithatë, nuk është kështu sepse në Shqipëri dënimi kapital nuk ekziston. Edhe këtë rrethanë nuk e normon KShq, por ekziston si standard kushtetuese përmes internalizimit të detyrimeve ndërkombëtare të vendit pas pranimit në KE. Arsyeja për heqjen e dënimit me vdekje në Shqipëri si dhe në vendet e tjera evropiane është nënshkrimi i Protokollit nr. 6 të **KEDNJ**-së, që heqjen e dënimit me vdekje (përveç rrethanave të kohës së luftës). Në Shqipëri kjo hyri në fuqi më 1 tetor 2000. Dënimi me vdekje është përdorur shumë në Shqipëri nga 1941-1985. Përfundimisht, në vitin 2007 Shqipëria ratifikoi Protokollin Nr. 13 të **KEDNJ**-së, duke shfuqizuar dënimin me vdekje në të gjitha rrethanat, dhe duke e zëvendësuar atë me burgim të përjetshëm.

Neni në vijim i **KShq** garanton **lirinë e shprehjes** (parag. 1 i nenit 22). Më pas, në paragrafin e dytë specifikohen trajtat e lirisë së shprehjes - liria e shtypit, e radios dhe e televizionit, të cilat garantohen. Nisur nga përvoja e hidhur me diktaturën komuniste, paragrafi i tretë në mënyrë shprehimore ndalon censurën e mjeteve të komunikimit. Dhënia e autorizimit për funksionimin e stacioneve të radios ose të televizionit mund të kërkohet me ligj (neni 22 parag. 4). Në mënyrë krejt të natyrshme pason normimi i të **drejtës për informim**, duke përshkruar trajtat e manifestimit të saj (neni 23). E para trajtë është e drejta kujtdo për të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore (parag. 2 i nenit 23). Dhe, trajta e dytë është e drejta kujtdo për të pasur mundësi të ndjekjes së mbledhjeve të organeve të zgjedhura kolektive (parag. 3 i nenit 23).

Në nenin 24 të **KShq** garantohet **liria e ndërgjegjes dhe fesë** (neni 24). Secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t'i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve (parag. 2 i nenit 24). Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohet të marrë pjesë në një bashkësi fetare ose në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij (parag. 3 i nenit 24).

Neni 26 në vijim, në një fjali të vetme normohet **ndalimi i torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor poshtërues** (neni 25), kurse neni 26 sanksionon një ndalesë të ngjashme me këtë – **ndalimin e punës së detyruar**: Askujt nuk mund t'i kërkohet të kryejë një punë të detyruar, përveçse në rastet e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor, të kryerjes së shërbimit ushtarak, të një shërbimi që rrjedh nga një gjendje lufte, nga një gjendje e jashtëzakonshme ose nga një fatkeqësi natyrore, që kërcënon jetën ose shëndetin e njerëzve. Kjo gjendje në praktikë, zakonisht vjen si pasojë e pozitës poshtëruese dhe skllavëruese në të cilën ndodhen njerëzit, duke u detyruar në kryerjen e punëve që degradojnë dinjitetin njerëzor.

Neni 27 i **KShq** përdor formulimin standard nga **KEDNJ**, siç përdor kushtetutëbërësi shqiptar në shumicën e tekstit të kapitullit dy, kur normon lirinë: Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj (parag. 1 i nenit 27). Paragrafët tjerë pak a shumë janë të njëjtë me kushtetutat e vendeve fqinje me **Kosovën**, duke normuar qartë kushtet dhe rrethanat nën të cilat mund të ndodh heqja lirisë. Në nenin 28 të **KShq** jepen **garancionet kushtetuese të natyrës procedurale**, për dallim nga ato të paragrafit pararendës që përmban **garancione të natyrës material-juridike**, me fillim nga e drejta e personit që i hiqet liria për t'u njoftuar në gjuhën që kupton për masat dhe akuzat ndaj tij e deri te e drejta e trajtimit njerëzor dhe respektimit të dinjitetit. Në mënyrë të njëjtë, edhe neni 29 i KShq përdor formulimet e **PDCP-së** lidhur me parimin e legalitetit: ai i takon kujtdo, përveç atyre që kanë kryer vepra, të cilat në kohën e kryerjes së tyre, përbënin krime lufte ose krime kundër njerëzimit sipas së drejtës ndërkombëtare. Në po këtë nen gjendet edhe parimi i zbatimit të ligjit më të butë, sa i përket dënimit, edhe atëherë kur ai më nuk është në fuqi. Menjëherë në nenin 30 garantohet prezumimi i pafajësisë, kurse në nenin 31 shpaloset lista e të drejtave që ka çdo kush që ballafaqohet me një proces penal (të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t'i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij; të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet; të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe; të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme; dhe t'u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet).

Garancionet kushtetuese proceduralo-penale vazhdojnë me nenin 31 të **KShq**, në të cilin theksohet ndalesa e vetinkriminimit në një proces penal dhe ndalesa e përdorimit të provave të marra në mënyrë të paligjshme. Natyrë të njëjtë ka edhe garancioni nga neni 32, që thotë se "Kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet". U mor vesh, nga ky garancion kushtetues nuk mund të përfitojnë personat që i ikin drejtësisë (parag. 2 i nenit 32). Parimin **ne bis in idem**, lexuesi i **KShq** e gjen në nenin 34, me përjashtim

të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj. Këtë formulim nuk e hasim në **KKos**. Me këtë, kushtetutëbërësi shqiptar e bënë të qartë se nuk cenohet parimi në fjalë nëse ekziston një rigjykim, sipas procedurave të paracaktuara ligjore.
Përbërësit e të **drejtës së privatësisë** fillojnë të normohen nga neni 35 i **KShq**. Në këtë nen rregullohet mbrojtja e të dhënave të mbledhura që lidhen me personin si dhe përjashtimet ligjore që lejojnë zbulimin e tyre. Liria dhe fshehtësia e korrespondencës pason në nenin 36, kurse në nenin 37 garantohet paprekshmëria e banesës. Njëjtë si në rastin e Kosovës dhe vendeve përreth saj, kushtetutëbërësi shqiptar ka përcaktuar situatat dhe kushtet nën të cilat mund të vjen deri te përjashtimi nga respektimi i këtyre garancioneve kushtetuese.

Liria e lëvizjes dhe e zgjedhjes së vendbanimit normohen me nenin 38 të **KShq**, kurse në nenin 39 ndalohet dëbimi i shtetasve shqiptar jashtë shtetit. Çështja e ekstradimit normohet në mënyrë më të saktë, si një garancion kushtetues, se sa në rastin e **KKos**: ”Ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat **Republika e Shqipërisë** është palë, dhe vetëm me vendim gjyqësor”, thotë kushtetutëbërësi shqiptar. Siç shihet, dy kritere kërkohen për ekstradim: një - pasja e një marrëveshjeje ndërkombëtare; dhe, dy - ekzistimi i një vendimi gjyqësor. Pra, këto janë garancione kushtetuese, jo përcaktime ligjore, si në Kosovë dhe disa vende të tjera. Këtë përcaktim ligjor, **KShq** e parashikon për kategorinë e dëbimit: ”Ndalohet dëbimi kolektiv i të huajve. Dëbimi i individëve të huaj lejohet në kushtet e përcaktuara me ligj“ (neni 39 parag. 3).

Edhe **prona** normohet më gjerësisht në **KShq**, krahasuar me **KKos**: në nenin 41, në pesë paragrafë, kushtetutëbërësi shqiptar, në një mënyrë shumë të detajuar, ka definuar statusin kushtetues të pronës. E drejta e pronës private është e garantuar (parag. 1 i nenit 41). Paragrafi në vijim flet për mënyrat e fitimit të pronës dhe saktëson se prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil. Paragrafi i tretë, ndërkaq, lejon ligjvënësin shqiptar që me ligj të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë. Ato shpronësime ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë (parag. 4 i nenit 41). Në fund fare, paragrafi i pestë thekson se për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë. Ky trajtim i pronës në **KShq** është shumë më i plotë se në Kosovë dhe i përafërt me standardet evropiane mbi pronën të përcaktuara nga KEDNJ-ja dhe protokollet e saj dhe praktika e **Strasburgut**.

Neni 42 i **KShq**, në dy paragrafë normon dy kategori të të drejtave: të drejtën për gjykim të rregullt (paragrafi i parë) dhe të drejtën për gjykim në kohë të arsyeshme. Kjo e fundit nuk ekziston në **KKos** dhe përbën një risi në sferën e garancive kushtetuese që lidhet me faktin se **Shteti shqiptar**, pas anëtarësimit në **KE**, ka pasur shumë raste në **Strasburg** në të cilat ka humbur gjyqet kundër shtetasve të vet dhe është dashur të paguaj shuma të mëdha, pikërisht për shkak të zvarritjes pafund dhe në kohë të gjatë të proceseve gjyqësore. Dy nenet e fundit të kategorisë së lirive dhe të drejtave vetjake normojnë garancitë kushtetuese që kanë të bëjnë me të drejtën për ankesë (neni 43) dhe të drejtën për rehabilitim dhe/ose zhdëmtim të çdo kujt në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.

Të drejtat dhe liritë politike - Vetëm tri nene që i kushtohen lirive dhe të drejtave politike, nenet 45-48, i posedon kreu i tretë i **KShq**. Neni 45 normon të drejtat zgjedhore, të drejtën aktive dhe pasive zgjedhore. Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjet, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedh dhe të zgjidhet (parag. 1 i nenit 45). Përjashtohen nga e drejta e zgjedhjes shtetasit e deklaruar me vendim gjyqësor të formës së prerë si të paaftë mendërisht (parag. 2 i nenit 45). Ky paragraf, pra, normon përjashtimin nga e drejta aktive zgjedhore. Paragrafi i tretë flet për përjashtimin nga e drejta pasive zgjedhore dhe është më i strukturuar se pararendësi i tij: ”Përjashtohen nga e drejta për t’u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përfundimtar të formës së prerë, për kryerjen e një krimi, sipas rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në

raste përjashtimore dhe të justifikuara, ligji mund të parashikojë kufizime të së drejtës për të zgjedhur të shtetasve që vuajnë dënimin me heqje lirie, ose të së drejtës për t'u zgjedhur para dhënies së një vendimi përfundimtar apo kur shtetasit janë dënuar për një krim ose për cenim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike". Sikundër shihet, pra, neni 45 i KShq ndryshon dukshëm nga neni i njëjtë i KKos: në Kosovë duhet që të drejtat zgjedhore pasive të merren me vendim nga gjykata kompetente, kurse në Shqipëri normohen tri situata që përbëjnë përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i të drejtës zgjedhore. E para, të drejtën aktive zgjedhore mund ta ketë të kufizuar personi që vuan dënimin me heqje lirie, por që këtë e përcakton ligjvënësi shqiptar, jo gjykata përkatëse. E dyta, të drejtën pasive zgjedhore mund ta ketë të kufizuar personi akoma para dhënies së një vendimi përfundimtar. Dhe, së fundi, të drejtën pasive zgjedhore mund ta ketë të kufizuar personi që ka kryer krim të rënd dhe serioz apo cenim të sigurisë publike. Këto përjashtime duhet të dallohen nga rregulli i përgjithshëm kushtetues lidhur me përjashtimin nga të drejtat pasive zgjedhore, që normohen me fjalinë e parë të paragrafit të tretë të nenit 45 si më sipër: këtu vendimi i gjykatës që përjashton personin e caktuar nga e drejta pasive zgjedhore si dhe krimi i kryer nuk janë vendimtar në mënyrë të izoluar, sepse kërkohet që, krahas tyre, edhe baza juridike e vendimit mbi fajësinë të ankorohet në një ligj që miratohet me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në paragrafin e fundit sanksionohet shenjtëria e votës, e cila është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.

Neni 46 i **KShq** normon **lirinë e asociimit**, në tre paragrafë. I pari thotë se kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm. I dyti, për dallim nga neni 44.1 i **KKos** që nuk kërkon leje, përcakton se regjistrimi në gjykatë i organizatave ose i shoqatave bëhet sipas procedurës së parashikuar me ligj. Kjo nënkupton se një ligj mund ta përcaktojë sistemin e lejes për të regjistruar në gjykatë një organizatë ose shoqatë. Paragrafi i tretë, krejt natyrshëm e bën të ditur se, organizatat ose shoqatat që ndjekin qëllime antikushtetuese janë të ndaluara sipas ligjit. Sikundër shihet, **KShq**, në këtë nen nuk ka normuar **lirinë e organizimit sindikal** në mënyrë të posaçme.

Ngjashëm me nenin 43 të **KKos**, neni 47 i **KShq** normon lirinë e tubimit, por me një gjuhë më të saktë: Liria e tubimeve paqësore dhe pa armë, si dhe e pjesëmarrjes në to është e garantuar (parag. 1 i nenit 43). Paragrafi i dytë i këtij neni, për dallim nga neni 43 i **KKos**, nuk normon kufizimin e kësaj të drejte dhe as nuk jep arsyet për një gjë të tillë. Në paragrafin e dytë vetëm bëhet referim në ligj, pas përshkrimit të natyrës së tubimeve. Tubimet paqësore në sheshe dhe në vendet e kalimit publik, e thotë ky paragraf, bëhen sipas procedurave të parashikuara me ligj.

Neni i fundit i këtij kreu, neni 48, normon të drejtën e peticionit apo të drejtën e parashtresave, diçka që nuk ekziston në KKos. Kush do, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t'u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj, përcaktohet në këtë nen që ka vetëm këtë paragraf të vetëm.

Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore - Nenet 49 deri 58 të kreut të katërt të **KShq** i dedikohen të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, kurse neni i vetëm i kreut të pestë, neni 59, i kushtohet **objektivave sociale**, titull që figuron para tij dhe përbën pjesë integrale të çdo interpretimi të kësaj kategorie të lirive dhe të drejtave kushtetuese.

Në nenin 49 gjenden garancionet e të **drejtës së punës** dhe **lirisë për ushtrimin e profesionit**: Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë ta zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional (neni 49 parag. 1). Sigurimi shoqëror gjendet në paragrafin e dytë të nenit të njëjtë: Të punësuarit kanë të drejtën e mbrojtjes shoqërore të punës. Kjo mbrojtje, pra, i takon vetëm të punësuarve dhe lidhet me marrëdhënien e punës së formuar sipas ligjit.

Bashkimi sindikal garantohet në nenin në vijim, nenin 50 të **KShq**., në një paragraf të vetëm, që thotë se "të punësuarit kanë të drejtë të bashkohen lirisht në organizata sindikale për mbrojtjen e interesave të

tyre të punës". Ngushtësisht e lidhur me këtë garancion kushtetues është e **drejta për grevë**, që normohet me nenin 51 në kontekstin e marrëdhënies së punës: "E drejta e të punësuarit për grevë që ka të bëjë me marrëdhëniet e punës, është e garantuar" (neni 50 parag. 1). Kufizimi i kësaj të drejte pason natyrshëm, me arsyetimin e mbrojtjes së interesave të përgjithshme të shoqërisë: "Kufizime për kategori të veçanta të punësuarish mund të vendosen me ligj për t'i siguruar shoqërisë shërbimet e domosdoshme". (neni 50 parag. 2).

E drejta e sigurimit dhe ndihmës sociale gjendet në nenin 52 të **KShq**., në vetëm dy paragrafë: "Kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paaftë për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj" (neni 51 parag. 1) dhe "Kushdo, kur mbetet pa punë për shkaqe të pavarura nga vullneti i tij dhe kur nuk ka mjete të tjera jetese, ka të drejtën e ndihmës në kushtet e parashikuara me ligj".

E drejta e martesës dhe familjes sanksionohet në nenin 53, në tre paragrafë. Paragrafi i parë thotë se "kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje", pa definuar martesën si bashkësi e sekseve të kundërta, siç e bëjnë disa kushtetuta. Paragrafi i dytë garanton se "Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit", sërish pa u bazuar në gjininë natyrore të atyre që janë në martesë. Paragrafi i tretë autorizon ligjvënësin shqiptar për rregullimin nga afërt lidhjen dhe zgjidhjen e martesës. Të drejtat e fëmijës, krejt natyrshëm gjenden në nenin në vijim, nenin 54 të **KShq**., së bashku me të drejtat e grave shtatzëna dhe nënat e reja, të cilët së bashku gëzojnë mbrojtjen e veçantë nga shteti (neni 54 parag. 1). Duke ndjekur standardin që e kanë të gjitha kushtetutat evropiane, kushtetutëbërsi shqiptar, njëjtë si ai kosovar, nuk ka bërë dallimin në mes të fëmijëve të lindur në martesë dhe atyre të lindur jashtë martese (neni 54 parag. 2). Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal, rregullohen në paragrafin e fundit të këtij neni.

Kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij, është formulimi i dispozitës së vetme kushtetuese që normon çështjet e mjedisit jetësor, pa përcaktuar ndonjë detyrim për organet e shtetit lidhur me mënyrën e mbrojtjes së këtij mjedisi (neni 55).

E drejta për arsimin është më e plotë në KShq., krahasuar me KKos. Kjo e drejtë normohet me nenin 56, në shtatë paragrafë. Aty garantohet e drejta për arsimim (parg.1). Arsimi shkollor i detyrueshëm caktohet me ligj (parag.2). Arsimi i mesëm i përgjithshëm publik është i hapur për të gjithë (parag.3). Arsimi i mesëm profesional dhe i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kritere aftësie (parag.4). Kjo dispozitë nuk gjendet në KKos., dhe përbën risi sepse me dispozitë kushtetuese garantohet **parimi i meritorkracisë**. Paragrafi i pestë ngjason shumë më stipulimin kosovar, sepse përcakton që arsimi i detyrueshëm, si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas. Edhe në **KShq** garantohet arsimimi në shkolla jopublike të të gjitha niveleve, të cilat krijohen e funksionojnë në bazë të ligjit (parag. 6). Së fundi, për dallim nga **KKos** që garanton në mënyrë nebuloze vetëm lirinë akademike, në **KShq** saktësohet se **autonomia e institucioneve të arsimit të lartë** dhe **liria akademike** janë të garantuara me ligj (parag.7). Këtu, pra, kushtetutëbërësi e ka detyruar ligjvënësin shqiptar që me ligj të sanksionoj **autonominë institucionale**. Për dallim nga Kosova, në Shqipëri liria artistike dhe kërkimi shkencor janë të ndara nga liria akademike. Lirisë artistike dhe shkencore i shtohet edhe mbrojtja e të drejtës së autorit. Mirëpo, në ndërkohë që me ligj garantohet mbrojtja e të drejtës së autorit (neni 58 parag. 2), liria e krijimit artistik dhe e kërkimit shkencor, vënia në përdorim si dhe përfitimi prej arritjeve të tyre janë të garantuara për të gjithë (neni 58 parag. 1). Këtu, njëjtë si në Kosovë, në mënyrë të drejtpërdrejtë garantohet liria e krijimit artistik dhe e kërkimit shkencor.

Objektivat sociale nga neni 59 i **KShq** janë një zgjidhje unikate kushtetuese në rajon: në dy paragrafë, por në një vend të vetëm, aty shpalosen synimet e Shtetit shqiptar në disa fusha. Paragrafi i parë thotë se Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:

a) punësimin në kushte të përshtatshme të të gjithë personave të aftë për punë;
b) plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim;
c) standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm;
ç) arsimimin dhe kualifikimin sipas aftësive të fëmijëve dhe të të rinjve, si dhe të personave të pazënë me punë;

d) një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;
dh) shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm;
e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët;
ë) zhvillimin e sportit dhe të veprimtarive ripërtëritëse;
f) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës;
g) mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare, kulturore dhe kujdesin e veçantë për gjuhën shqipe.

Paragrafi i fundit, megjithatë, e bën të qartë për qytetarin dhe çdo kënd tjetër se përmbushja e objektivave socialë nuk mund të kërkohet drejtpërdrejt në gjykatë. Kjo do të thotë se ato nuk janë të gjykueshme. Në këtë paragraf, ligjvënësi shqiptar autorizohet që t'i përcaktojë kushtet dhe masën në të cilat mund të kërkohet realizimi i këtyre objektivave.

7.3.2. Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut në Maqedoninë e Veriut

Kapitulli i dytë i **KMver** normon liritë dhe të drejtat e njeriut, të cilat i ndan sipas gjeneratave, por nuk fillon më pjesën e dispozitave të përgjithshme për këtë kapitull, siç bëjnë **KKos** dhe **KShq**. Në KMver ndarja bëhet në dy kategori: në liritë dhe të drejtat civile dhe politike dhe në të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore.

Edhe në Maqedoninë e Veriut, bazat për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të pakicave gjenden në dispozitat kushtetuese që në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me mbrojtjen e tyre, si dhe në dispozitat mbi kompetencat e organeve shtetërore në të gjitha nivelet.

Sa i përket mekanizmit mbrojtës së lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të pakicave, edhe **KMVer** njeh mbrojtjen gjyqësore, mbrojtjen pranë **Gjykatës Kushtetuese** dhe mbrojtjen nga **Avokati i Popullit.**

Mbrojtja fillestare pranë gjykatave dhe në Gjykatën Kushtetuese normohen në një seksion të të veçantë, seksionin tre të kapitullit të dytë të **KMVer**, që mban titullin "Garancitë e lirive dhe të drejtave themelore". Ky nen ka tre paragrafë, i pari ndër të cilët ofron garancion për rrugën gjyqësore dhe mekanizimin e Gjykatën Kushtetuese për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore: Çdo qytetar mund të thirret në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të përcaktuara me Kushtetutë, para gjykatave dhe para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë, në procedurë të mbështetur mbi parimet e prioritetit dhe urgjencës (neni 50 parag. 1). Sa i përket Gjykatës Kushtetuese, megjithatë, duhet vënë re se jo për të gjitha të drejtat nga kapitulli i dytë mund të kërkohet mbrojtja e saj. Sipas nenit 110, pranë Gjykatës Kushtetuese mund të kërkohet mbrojtja vetëm për liritë dhe të drejtat e njeriut e të qytetarit, që kanë të bëjnë me lirinë e bindjes, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimeve, bashkimin dhe veprimin politik dhe ndalimin e diskriminimit të qytetarëve mbi bazë të gjinisë, racës, fesë, përkatësisë kombëtare, sociale dhe politike.

Pjesë e këtij garancioni nga neni 50 i kapitullit të tretë të **KMVer** është edhe mbrojtja gjyqësore e ligjshmërisë së akteve të veçanta të administratës shtetërore dhe të institucioneve të tjera që ushtrojnë autorizime publike (neni 50 parag. 2). Në nivel të së drejtës së përgjithshme, paragrafi i fundit i nenit 50 proklamon të drejtën e qytetarit që të njoftohet me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në

mënyrë aktive të kontribuojë, individualisht ose bashkë me të tjerët, për përparimin dhe mbrojtjen e tyre. Ky proklamim kushtetues i kësaj të drejte ka për qëllim fuqizimin e rolit të qytetarit në shoqëri, përmes një formulimi të përgjithshëm që autorizon qytetarët e këtij vendi për të marrë pjesë në përparimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut në çdo kohë, vend dhe pranë çdo institucioni maqedonoverior.

As **KMVer** nuk përmban dispozita shprehimore që kanë formë garancioni kushtetues për qytetarët e vendit, për të shfrytëzuar mekanizmat juridikë dhe gjyqësorë ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të tyre (**GJEDNJ** dhe **Komiteti i OKB**-së). Mirëpo, marrë parasysh faktin se Maqedonia e Veriut është anëtare e **KE-së** dhe e **OKB-së** dhe, për pasojë, i **KEDNJ-së** dhe **PDCP-së**, nënkuptohet se ekziston e drejta e qytetarëve dhe subjekteve të tjerë të së drejtës në këtë vend për t'iu drejtuar këtyre institucioneve ndërkombëtare dhe forumeve të tjera.

Avokati i Popullit mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve të cilat u janë cenuar nga organet e administratës shtetërore dhe nga organet e organizatat e tjera të cilat kanë autorizime publike (neni 77 parag. 2). Mbrojtja që ofron ky organ, megjithatë, njëjtë si në Kosovë dhe Shqipëri, nuk është juridike sepse vendimet e marra në vijim të mbrojtjes së të drejtave, lirive dhe interesave individuale nuk kanë fuqi ekzekutive (nuk mund të ekzekutohen me dhunë).

Sikundër shihet, konceptualisht, nuk ka ndonjë dallim në mes të zgjidhjeve kushtetuese në Maqedoninë e Veriut dhe Kosovës e Shqipërisë, sa i përket mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut. I vetmi dallim është se Kosova, për dallim nga **KShq** dhe **KMVer**, nuk bën kategorizimin e lirive dhe të drejtave sipas gjeneratave, gjë që e bën më të vështirë shfrytëzimin dhe interpretimin e tyre nga subjektet e së drejtës dhe institucionet shtetërore.

Liritë dhe të drejtat civile dhe politike - Kjo kategori e lirive dhe të drejtave normohet me nenet 9-29 të KMVer. Para garantimit kushtetues të së **drejtës për jetë**, kushtetutëbërësi maqedonoverior ka sanksionuar të **drejtën për barazi** të qytetarëve të vendit (neni 9). Qytetarët e Republikës së Maqedonisë janë të barabartë në liritë dhe të drejtat pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, prejardhja kombëtare dhe sociale, bindja politike dhe fetare, pozita pronësore dhe shoqërore (neni 9 parag.1). Kjo barazi ka të bëjë me barazinë formale: Qytetarët janë të barabartë para Kushtetutës dhe ligjeve (neni 9 parag.2).

Garantimi i të **drejtës për jetë** në **KMVer** është më i qartë se në **KShq**, për faktin se, siç u pa, në rastin shqiptar, një garancion i tillë nuk figuron fare. Jeta e njeriut është e pacenueshme (neni 10 parag.1). Në Republikën e Maqedonisë nuk mund të shqiptohet dënimi me vdekje sipas asnjë baze (neni 10 parag. 2). Kjo nënkupton se, Maqedonia e Veriut, me normë kushtetuese, jo përmes internalizimit të detyrimit ndërkombëtar, siç ka bërë Shqipëria, ka ndaluar dënimin me vdekje, për çfarëdo arsye qoftë.

E drejta e integritetit personal, **fizik** dhe **moral**, normohet në tre paragrafë të nenit 11 të KMVer, që përfshinë edhe ndalimet e caktuara kushtetuese që cenojnë këtë integritet. Integriteti fizik dhe moral i njeriut janë të pacenueshëm (neni 11 parag.1). Ndalohet çdo formë e torturës, e sjelljes dhe e dënimit çnjerëzor dhe poshtërues (neni 11 parag. 2). Paragrafi i fundit ndalon punën me detyrim. Siç mund të vërehet, kjo e drejtë është më pak e strukturuar dhe me më pak përmbajtje se në rastin e KKos, e cila në nenin 26 përfshinë edhe përbërës të tjerë të kësaj të drejte, siç janë: reproduktimi biologjik dhe ndalimi i eksperimenteve mjekësore të natyrës së caktuar. Përveç kësaj, në **KKos**, ndalimi torturës, e sjelljes dhe e dënimit çnjerëzor dhe poshtërues specifikohet si një kategori e veçantë e të drejtave njerëzore. Njëjtë vlen edhe për punën e detyruar dhe skllavërinë, që ndahen si një kategori e posaçme e të drejtave.

Edhe **e drejta e lirisë** është shumë më e varfër në përmbajtje, krahasuar me KKos: në **KMVer** nuk jepen bazat e heqjes së lirisë. Ato baza i cakton ligjvënësi maqeodnoverior, gjë që e bënë këtë garancion kushtetues të ketë fuqi më të dobët se garancioni njëjtë në KKos. Draftimi i dispozitave në **KKVer**, megjithatë, që kanë të bëjnë me dallimet terminologjiko-juridike të koncepteve që përshkruajnë trajtat

e privimit nga liria janë më të sakta dhe më të qarta. Pasi garanton pacenueshmërinë e lirisë së individit (neni 12 parag.1), **KKVer** e bën të qartë se askujt nuk mund t'i kufizohet liria, përveçse me vendim të gjykatës dhe në raste e në procedurë të përcaktuar me ligj (neni 12 parag.2). Kur kjo ndodhë, megjithatë, ekzistojnë disa garancione për personin e privuar nga liria: Personi i thirrur, i arrestuar ose i privuar nga liria duhet medoemos menjëherë të njoftohet me shkaqet për thirrjen, arrestimin ose privimin e tij nga liria dhe me të drejtat e tij të caktuara me ligj, dhe prej tij nuk mund të kërkohet deklaratë (neni 12 parag.3). Për realizimin e këtij garancioni kushtetues, personi i thirrur, arrestuar ose privuar nga liria ka të drejtën e mbrojtës në procedurën policore dhe gjyqësore (neni 12 parag. 4). Pjesë e këtij garancioni është edhe stipulimi në parag. 5 të nenit të njëjtë që përcakton se personi i privuar nga liria duhet medoemos menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orësh nga momenti i privimit nga liria, të nxirret para gjykatës, e cila pa shtyrje do të vendos për ligjshmërinë e privimit nga liria. Nëse vjen deri te nevoja për paraburgim, atëherë ai mund të zgjasë me vendim të gjyqit, më së shumti 90 ditë nga dita e paraburgimit (neni 12 parag. 6). Në fund, **KMVer** e bën të qartë edhe për laikun se personi i paraburgosur, në kushte të caktuara me ligj, mund të lëshohet të mbrohet nga liria (neni 12 parag. 7).

Prezumimi i pafajësisë dhe e drejta e kompensimit për rastet e privimit pa të drejtë nga liria, paraburgimit dhe dënimit në mënyrë të paligjshme rregullohen me nenin 13 të **KMVer**, në dy paragrafë të vetëm. Sikundër shihet, këtu me plotë të drejtë, për dallim nga **KKos** dhe **KShq**, në një vend janë normuar prezumimi i pafajësisë dhe e drejta e kompensimit të dëmit dhe të drejtat tjera të përcaktuara me ligj. Parimi i legalitetit të veprës dhe dënimit penal normohet në nenin 14, në mënyrë të ngjashme me Shqipërinë dhe Kosovën, siç normohet edhe e drejta e ankesës, përkatësisht e drejta për mjete juridike në nenin 14 të KMVer.

Pas këtyre **garancioneve të natyrës proceduralo-juridike** dhe **materialo-juridike**, KMVer kalon në normimin e garancioneve që kanë të bëjnë me mendjen dhe shpirtin e njeriut: në nenin 16 garantohet **liria e bindjes, ndërgjegjes, mendimit dhe e shprehjes publike të mendimit**, në pesë trajtat e saj (liria e fjalës dhe paraqitjes publike, e drejta për qasje në informatë, e drejta e përgjigjes dhe korrigjimit në mjetet e informimit publik dhe, në fund, e drejta e mbrojtjes së burimit të informatës në mjetet e informimit publik), duke ndaluar në fund censurën si instrument që dëmton dhe shpërfytyron këtë garancion kushtetues. Ngjashëm me këtë garantohet edhe **liria dhe fshehtësia e letrave dhe të gjitha formave të tjera të kumtimit**, e cila mund të kufizohet me vendim gjyqësor dhe atë për arsye të mbrojtjes së interesit të përgjithshëm (zhvillimi i një procesi penal dhe interesit e mbrojtjes së interesit shtetëror) (neni 17). Ngushtësisht e lidhur me këtë është edhe një garancion tjetër, përkatësisht **siguria dhe fshehtësia e të dhënave personale**, që garantohen për aq sa këto kanë të bëjnë me mbrojtjen nga cenimi i integritetit personal (neni 18).

Liria e besimit fetar garantohet në nenin 19, me formulime të ngjashme si në Kosovë, Shqipëri dhe vendet tjera përreth. Edhe në KMVer, synim parësor është mbajtja e një qëndrimi neutral të shtetit në çështjet e fesë dhe besimit, duke i lënë këto pjesë të sferës private si liri dhe të drejta individuale të garantuara nga shteti.

Liria e bashkimit normohet në nenin 20, duke e kufizuar me interesat e rendit kushtetues. Për dallim nga Kosova, **KMVer** shprehimisht në këtë të drejtë fut edhe organizimin politik (partitë politike). Për dallim nga Kosova dhe Shqipëria, ndërkaq, KMVer shprehimisht ndalon formimin e **shoqatave ushtarake** ose **gjysmushtarake**, të cilat nuk u takojnë forcave të armatosura të Maqedonisë së Veriut (neni 20 parag. 4). Një e drejtë tjetër e ngjashme me këtë, **e drejta e tubimit paqësor** normohet me nenin 21, dhe mund të kufizohet vetëm në gjendje lufte dhe në kushte të gjendje së jashtëzakonshme. Për tubim nuk kërkohet leje (neni 21 parag. 1).

Të drejtat aktive dhe pasive zgjedhore, me formulime më të ndryshme se në Kosovë e Shqipëri, por me efekt të njëjtë, normohen në nenet 22 dhe 23 të KMVer. E drejta aktive mund të kufizohet vetëm për

rastet e humbjes së aftësisë së veprimit (neni 22 parag. 3), kurse për të drejtën pasive nuk vihet ndonjë kufizim shprehimor: Çdo qytetar ka të drejtë të marrë pjesë në ushtrimin e funksioneve publike (neni 23). **E drejta e ushtrimit të parashtresave organeve publike** dhe mospërgjegjësia për një gjë të tillë rregullohet me nenin 24, kurse neni 25 në vijim, për objekt rregullimi ka të **drejtën e privatësisë**. Neni 26 rregullon **paprekshmërinë e banesës** (shtëpisë) dhe bazat e kufizimit të kësaj të drejte, që janë të njëjta me zgjidhjet kushtetuese në Kosovë dhe vendet përreth.

Liria e lëvizjes dhe kufizimet e saj normohen me nenin 27 të **KMVer**, kurse mbrojtja e vendit cilësohet si e drejtë por edhe detyrë qytetare në nenin e saj 28. Neni i fundit 29 i lirive dhe të drejtave civile dhe politike merret me të **drejtat e të huajve**, në një mënyrë më të thuktë se në KKos. Në fillim garantohen të drejtat e të huajve, në parim, por duke u bazuar në ligj dhe marrëveshje ndërkombëtare (neni 29 parag. 1). Një e drejtë specifike e të huajve, **e drejta e azilit**, është objekt rregullimi në paragrafin e dytë të këtij neni, përfshirë këtu personat pa shtetësi. Bëhet fjalë për strehim nga përndjekja për shkak të bindjeve dhe veprimeve politike demokratike. Nga këto përjashtohen **veprat e terrorizmit** (neni 29 parag. 3). **Ekstradimi** të huajve dhe personave pa shtetësi mund të ndodhë vetëm në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar dhe në bazë të parimit të reciprocitetit (neni 29 parag. 3).

Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore - Kjo kategori e të drejtave kushtetuese nis me garantimin e të **drejtës së pronës** dhe të **drejtës së trashëgimisë** (neni 30 parag. 1). Me qasjen standarde, këtë mbrojtje e kufizon për të mirën e individit dhe të shoqërisë (neni 30 parag.2), kurse kufizimet e pronës dhe të drejtave që rrjedhin prej saj e lejon në rast të mbizotërimit të interesave të përgjithshme publike, siç i përcakton ligji (neni 30 parag. 3). Paragrafi i fundit normon eksproprijimin (shpronësimin) dhe kufizimin tjetër të pronësisë, që lejohet vetëm kundrejt një kompensimi që nuk është më i ulët se vlera e tregut të pronësisë apo të drejtave të tjera që merren ose kufizohen nga shteti për interes publik. **E drejta e të huajve për pronë** garantohet me nenin 31, nën kushtet e përcaktuara me ligj.

Pas pronës, **KMVer** kalon në normimin e të **drejtës së punës** dhe të drejtave të tjera që lidhen me punën dhe kategoritë e përafërta me të, duke garantuar barazi të plotë të qytetarëve në qasjen e këtyre të drejtave (neni 32). Mënyra e rregullimit të këtyre të drejtave është e ngjashme me Kosovën, Shqipërinë dhe vendet përreth: "Realizimi i të drejtave të të punësuarve dhe pozita e tyre, rregullohen me ligj dhe me marrëveshje kolektive", thuhet në paragrafin e fundit të këtij neni.

Detyrimi për të paguar **tatim** dhe **detyrime të tjera publike** si dhe për të marrë pjesë në përmbushjen e **shpenzimeve publike** në mënyrën e përcaktuar me ligj normohet në nenin 33 të KVer., në një paragraf të vetëm.

Neni 34 **KMVer** ka të bëj me drejtën e qytetarëve në **siguri sociale dhe sigurim social**, sipas kushteve të përcaktuara me ligj dhe me marrëveshje kolektive, kurse neni 35 me detyrimin e Shtetit për mbrojtje dhe siguri sociale, të drejtën e ndihmës qytetarëve të pafuqishëm dhe të paaftë për punë dhe sigurimin e mbrojtjes së veçantë të invalidëve dhe krijimin e kushteve për inkuadrimin e tyre në jetën shoqërore.

Neni 36 u garanton **të drejta të veçanta sociale luftëtarëve** të Luftës Antifashiste dhe nga të gjitha luftërat nacional-çlirimtare të Maqedonisë, invalidëve të luftës, të përndjekurve dhe të burgosurve për idetë e vetëqenies së popullit maqedonas dhe shtetformimit të tij, si dhe anëtarëve të familjeve të tyre të cilët nuk kanë mundësi për ekzistencë materiale dhe sociale (paragr. 1). Këto të drejta tutje operacionalizohen me ligj (parag. 2).

E drejta e organizimit sindikal normohet me nenin 37, përfshirë dhe kufizimet e kësaj të drejtë për kategori të caktuara të të punësuarve: me ligj mund të kufizohen kushtet për realizimin e të drejtës

së organizimit sindikal në forcat e armatosura, në polici dhe në organet e administratës (parag. 2). E drejta e grevës garantohet në nenin 38, e cila gjithashtu përmban kufizimet për kategoritë e caktuara të të punësuarve: Me ligj mund të kufizohen kushtet për realizimin e të drejtës së grevës në forcat e armatosura, në polici dhe në organet e administratës (parag. 2).

E drejta e mbrojtjes shëndetësore garantohet për secilin qytetar (neni 39), kurse shteti siguron kujdes dhe mbrojtje të veçantë familjes (neni 40). Neni i fundit përmban, si në vendet tjera përreth Kosovës, të drejta e garancione për fëmijët, por edhe një të drejtë të posaçme që nuk e hasim gjetiu: "Fëmijët e kanë për detyrë që të kujdesen për prindërit e moshuar dhe të pamundur", thotë paragrafi parafundit i nenit 40 të **KMVer**. Ndërkohëqë **Maqedonia e Veriut** udhëheq një politikë humane të popullimit (neni 41 parag. 2), është e drejtë e njeriut që lirisht të vendosë për të pasur fëmijë (neni 41 parag. 1). Neni 42 në vijim, sërish përmban dispozita me konkrete dhe më të sakta sa i përket fëmijëve dhe amësisë: Republika veçanërisht i mbron amësinë, fëmijët dhe personat e mitur (parag. 1), kurse personi më i ri se pesëmbëdhjetë vjet nuk mund të punësohet (parag. 2). Gjithnjë në kontekst të mbrojtjes së fëmijëve dhe nënave të tyre, personat e mitur dhe nënat kanë të drejtë në mbrojtje të veçantë gjatë punës (parag.3), në ndërkohë që ndalohet punësimi i të miturve në vendet e punës, të cilat janë të dëmshme për shëndetin dhe moralin e tyre (parag. 4).

7.3.3. Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut në Mal të Zi

Pjesa e dytë e **KMZi** normon liritë dhe të drejtat e njeriut dhe nis me parimet e përgjithshme. **KMZi** bën ndarjen e lirive dhe të drejtave të njeriut sipas gjeneratave. Krejt natyrshëm, niset me gjeneratën e parë të lirive dhe të drejtave personale (nenet 26-44), vazhdohet me liritë dhe të drejtat politike (nenet 45-57) dhe më pas me kategorinë e lirive dhe të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore (nenet 58-78). Sikundër shihet, këtu ka ngjashmëri të madhe me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Për dallim nga to, megjithatë, në **KMZi** në kuadër të pjesës së dytë normohen edhe të drejtat e posaçme të pakicave (nenet 79-80) dhe Avokati i Popullit (neni 81).

Njëjtë si në Kosovë dhe vendet tjera përreth, sikundër shihet, bazat për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të pakicave gjenden në dispozitat kushtetuese që në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me mbrojtjen e tyre. Ato gjenden edhe në dispozitat kushtetuese dhe ligjore mbi kompetencat e organeve shtetërore në të gjitha nivelet.

Sa i përket mekanizmit mbrojtës së lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të pakicave, edhe **KMZi** njeh mbrojtjen gjyqësore, mbrojtjen pranë **Gjykatës Kushtetuese** dhe mbrojtjen nga **Avokati i Popullit.**

Gjithashtu, edhe në Mal të Zi, mbrojtja fillestare bëhet pranë gjykatave të rregullta dhe më pas në Gjykatën Kushtetuese. Mirëpo, kjo çështje nuk normohet në një seksion të veçantë, si në **KMVer**, por në kuadër të dispozitave kushtetuese dhe ligjore mbi gjyqësorin dhe Gjykatën Kushtetuese. Për vënien në lëvizje të procedurave pranë Gjykatës Kushtetuese, neni 149.3 i **KMZi** kërkon shterrjen e mjeteve juridike efektive, në një mënyrë afërisht të njëjtë me KKos dhe KShq. Kjo radhitje e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave natyrshëm del në syprinë, për shkak se një pjesë e posaçme e **KMZi** i kushtohet kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë (pjesa e pestë).

Dispozitat e përgjithshme të pjesës së dytë të KMZi që normojnë liritë dhe të drejtat e njeriut, në fillim tregojnë se Kushtetuta dhe marrëveshjet ndërkombëtare janë bazë themelore për realizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut (neni 17 parag.1), kurse proklamohet se të gjithë janë të barabartë para ligjit, pa marrë parasysh cilësitë ose vetitë e caktuara personale (neni 17 parag. 2). Një barazi e caktuar garantohet nga shteti me një nen të veçantë, barazia gjinore (neni 18). Edhe neni në vijim merret me barazi, duke garantuar se çdokush ka të drejtë në mbrojtje të barabartë të lirive dhe të

drejtave të garantuara kushtetuese (neni 19). E drejta për mjet juridik kundër vendimit që vendos për liritë dhe të drejtat e njeriut, ose për ndonjë interes të mbrojtur me ligj, garantohet me nenin 20. Ndihma juridike gjithashtu gjendet në kuadër të dispozitave të përgjithshme, duke garantuar mbrojtjen falas në rastet e përcaktuara nga ligji.

Në kategorinë e garancioneve të përgjithshme kushtetuese hyjnë e drejta për vetëqeverisje lokale (neni 22), e drejta për ambient të shëndosh (neni 23), kufizimi i lirive dhe të drejtave (neni 24) dhe, së fundi, kufizimi i përkohshëm i lirive dhe të drejtave të njeriut (neni 25).

Në nenin 56, **KMZi** përmban garancione shprehimore kushtetuese për qytetarët e vendit për të shfrytëzuar mekanizmat juridikë dhe gjyqësorë ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Kjo dispozitë duhet të shihet në lidhshmëri me nenin 17.1 të KMZi, i cili shprehimisht përmend marrëveshjet ndërkombëtare si bazë për realizimin e lirive dhe të drejtave nga pjesa e dytë e saj. Kjo nënkupton se shtetasit e Malit të Zi kanë të drejtë të shfrytëzojnë të gjitha mekanizmat regjional dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre, ku vendi i tyre është palë kontraktuese.

Avokati i Popullit ndërmerr masa për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut (neni 81 parag. 1). Mbrojtja që ofron ky organ, megjithatë, nuk është mbrojtje juridike, njëjtë si në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut. Kjo sepse vendimet e marra në vijim të mbrojtjes së të drejtave, lirive dhe interesave individuale nuk kanë fuqi ekzekutive (nuk mund të ekzekutohen me dhunë). Në të vërtetë, vetë formulimi i paragrafit të parë të nenit 81 flet për ndërmarrjen e masave nga ana e Avokatit të Popullit, jo për mbrojtje efektive. Ky formulim më së miri reflekton natyrën jojuridike të mbrojtjes që ofron një avokat i popullit.

Sa i përket mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, sikundër shihet, konceptualisht, edhe në rastin malazez nuk ka ndonjë dallim në mes të zgjidhjeve kushtetuese me vendet tjera përreth. **KMZi** ndjek kategorizimin e lirive dhe të drejtave kushtetuese sipas gjeneratave, në mënyrë shprehimore, duke kategorizuar të njëjtat afërsisht në mënyrë të ngjashme me vendet tjera (përveç Kosovës).

Të drejtat dhe liritë personale - Ky seksion nis me ndalimin e dënimit me vdekje (neni 26). Dinjiteti i njeriut, për dallim nga **KKos** në të cilën përbën një kategori definuese e të gjitha të drejtave e lirive të tjera, në **KMZi** ai lidhet me ndalimin e zbatimit të eksperimenteve biologjike dhe mjekësore si dhe me modifikimin gjenetik të njeriut, i cili rreptësisht ndalohet. Pa pëlqimin e individit nuk mund të bëhen kontrollet mjekësore (neni 27). Ky nen mban emrin ”biomjekësia”. Pas tij vjen neni specifik që mban titullin “dinjiteti dhe pacenueshmëria e personalitetit” dhe ka katër paragrafë: i pari garanton dinjitetin dhe sigurinë e individit; i dyti garanton integritetin fizik dhe psikik të njeriut, privatësinë dhe të drejtat personale; i treti ndalon torturën, trajtimin çnjerëzor dhe poshtërues; i katërti dhe i fundit gjithashtu përmban një ndalesë – atë të skllavërimit dhe mbajtjes në pozitë skllavëruese të dikujt. Pra, sikundër shihet, as këtu dinjiteti i njeriut nuk shërben si definues i krejt kapitullit mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, por vetëm në kontekstin specifik të pacenueshmërisë së personalitetit që lidhet me katër kategoritë si më sipër. Normimi i dinjitetit pasohet nga garantimin e lirisë, që përfshinë kushtet dhe rrethanat nën të cilat mund të vij deri te privimi nga gëzimi i kësaj të drejte (neni 29). Redaktimi i këtij neni është shumë i ngjashëm me KKos dhe kushtetutat e vendeve përreth: ky garancion ka të bëj me shtetin, ndaj të cilit kushtetutat vejnë detyrime konkrete lidhur me kushtet dhe mënyrat e privimit të individit nga liria, përfshirë dhe të drejtat e tij themelore gjatë kohës sa ndodhë privimi tillë. I vetmi dallim konsiston në atë se në KMZi, në paragrafin e fundit, garantimin i lirisë ka të bëjë edhe me të tjerët, jo vetëm me pushtetin publik. Aty thuhet se është i dënueshëm privimi joligjor i lirisë. U mor vesh, kjo dispozitë nuk mund të zbatohet drejtpërdrejt nga gjyqet dhe organet tjera, sepse do të ishte në kundërshtim me parimin e legalitetit, sipas të cilit vepra dhe dënimi caktohen me ligj, por shërben si garancion

të cilën duhet ta operacionalizoj ligjvënësi me legjislacionin adekuat penal.

Në ndërkohë që privimi i lirisë përfshinë krejt situatat që përcaktohen me ligj, sipas garancionit dhe autorizimit kushtetues nga neni 29 si më sipër, neni 30 në mënyrë specifike rregullon **paraburgimin**, kushtet nën të cilat mund të bëhet, arsyet për një gjë të tillë dhe garancionet në dobi të personin të paraburgosur. Konceptualisht këto normime nuk dallojnë nga **KKos** dhe kushtetutat e vendeve përreth. Neni 31 në mënyrë të posaçme rregullon **respektimin e personalitetit të njeriut** gjatë zhvillimit të procedurave penale dhe procedurave të tjera në të cilat vendoset për liritë dhe të drejtat e saj/tij. Dinjiteti dhe personaliteti i njeriut duhet të respektohen, thuhet në paragrafin e parë të këtij neni, në ndërkohë që i dyti paragraf në mënyrë shprehimore ndalon ushtrimin e dhunës dhe praktikave të tjera të dhunshme, poshtëruese dhe çnjerëzore ndaj personit të privuar nga liria apo ndaj personit liria e të cilit është kufizuar, me qëllim të nxjerrjes së deklaratave apo marrjes së pranimit të veprës dhe fajit.

Gjykimi i drejtë, publik, i paanshëm dhe në një kohë të arsyeshme garantohet me nenin 32, kurse neni 33, njëjtë si në **KKos**, sanksionon **parimin e legalitetit**, i cili, në mënyrë të qartë dhe shprehimore i referohet vetëm dënimit për një vepër penale që nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si e tillë në kohën e kryerjes. Zbatimi i ligjit më të butë përcaktohet në nenin vijues, kurse prezumimi pafajësisë në nenin 35, i pasuar natyrshëm nga parimi ne bis in idem (neni 36). Garancioni procedural i të **drejtës për mbrojtje** gjendet në nenin 37, kurse kompensimi i dëmit për privim të paligjshëm nga liria apo dënim të paligjshëm në nenin 38.

Liria e lëvizjes dhe e vendosjes normohet me nenin 39, që përcakton kushtet dhe arsyet e kufizimit të kësaj të drejte. Ky nen gjithashtu autorizon ligjvënësin malazez që të rregullon me ligj caqet dhe përmbajtjen e kësaj të drejte për të huajt.

Privatësia përfshin garantimin e të drejtës së privatësisë dhe jetës familjare (neni 40). **Pacenueshmëria e banesës**, që rregullohet me nenin 41, ka natyrë të ngjashme me zgjidhjet kushtetuese të vendeve përreth Malit të Zi, sic ka edhe fshehtësia e korrespondencës (neni 42). **Të dhënat personale** garantohen në nenin 43. Sikundër shihet, kushtetutëbërësi malazez i ka veçuar qartë këto tri forma të manifestimit të privatësisë, duke u ofruar mbrojtje secilës prej tyre në mënyrë të qartë.

E drejta e azilit pak a shumë është sikur në vendet përreth dhe, pa asnjë dyshim, ndjek standardet aktuale të së drejtës ndërkombëtare në këtë sferë (neni 44). Me këtë mbyllet seksioni mbi liritë dhe të drejtat personale.

Të drejtat dhe liritë politike - Ky grupim i të drejtave nis me **të drejtat zgjedhore** - të drejtën aktive dhe pasive zgjedhore (neni45). Mosha për realizimin e kësaj të drejtë është 18 (tetëmbëdhjetë) vjet. Garantohet edhe e drejta e votës, njëjtë si në vendet përreth. KMZi, megjithatë, nuk jep arsyet, kushtet e kufizimit apo privimit të kësaj të drejte.

Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë normohet në një nen të vetëm dhe në mënyrë të ngjashme me vendet përreth (46). Të gjitha format e manifestimit të **lirisë së shprehjes**, ndërkaq (me shkrim, me gojë, me pamje ose në mënyrë tjetër), garantohet në nenin 47. **Kundërshtimi i ndërgjegjes** i lejohet çdo kujt në nenin 48 dhe formon një të drejtë të qartë kushtetuese që lidhet në veçanti me përdorimin e armëve, përkatësisht me të drejtën e personit për refuzim të përdorimit të tyre në emër të kësaj të drejte kushtetuese.

Liria e shtypit dhe **ndalimi i censurës** normohen respektivisht me nenet 49 dhe 50, dhe kanë përmbajtje afërsisht të njëjtë me kushtetutat përreth Malit ët Zi dhe vendet ish-komuniste të Evropës. Këto liri dhe garancione kushtetuese kanë qenë më së shumti të ndrydhura në vendet ish-komuniste, prandaj

edhe dispozitat kushtetuese të vendeve ish-komuniste, përfshirë vendet e Ballkanit Perëndimor, kanë një qartësi të madhe. Ngjashëm është situata edhe me të **drejtën për qasje në informata** nga neni 51 në vazhdim.

Liria e tubimit dhe asociimit janë objekt normimi me dispozitat e neneve 52 dhe 53, kurse kufizimet e kësaj të fundit janë më të qarta se në KKos: në mënyrë specifike tregon zyrtarët shtetërorë dhe zyrtarët tjerë publikë që nuk gëzojnë të drejtën e organizimit politik si dhe ndalon organizimin politike të partive që nuk kanë selinë në Mal të Zi (neni 54). Krejt natyrshëm pason **ndalesa tjetër e organizatave dhe formacioneve të tjera politike** që punojnë kundër rendit kushtetues të vendit, sovranitetit dhe integritetit territorial, cenojnë liritë dhe të drejtat e garantuara kushtetuese, nxisin urrejtje dhe jotolerancë nacionale, racore e fetare dhe jotolerancë të natyrës tjetër (neni 55).

E drejta për adresim organizatave ndërkombëtare dhe autoriteteve vendore, si dy të drejta të veçanta, normohen respektivisht me nenet 56 dhe 57 të **KMZi**. Në rastin e parë, çdo kujt i garantohet e drejta për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave kushtetuese pranë forumeve ndërkombëtare, kurse në të dytin nuk bëhet fjalë për kërkim të mbrojtjes juridike në kuptimin e mirëfilltë të kësaj fjale, por për të drejtën e qytetarëve malazezë për të dërguar parashtresa e kërkesa për çfarë problemi ose çështje. Për këtë qytetarët nuk mund të ftohen në përgjegjësi përveç rasteve kur me adresim organit shtetëror ose organizatës që kryen autorizime publike është kryer vepër penale (neni 57.2). Kjo e drejtë ka për qëllim njohjen e qytetarit si pjesëmarrës aktiv në jetën publike por edhe të shërbejë si një derë për shfaqjen e pikëpamjeve vetjake mbi çdo çështje që lidhet me të dhe të tjerët. Këto dy të drejta e mbyllin seksionin e parë mbi liritë dhe të drejtat e njeriut që ka të bëjë me liritë dhe të drejtat politike.

Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore - Ky seksion i **KMZi** ka njëzetë nene, nenet 58 – 78 dhe është më i detajuar se në secilën prej kushtetutave të vendeve fqinje me Kosovën, përveç **KSerb**.

Neni 58 i **KMZi** nis me **pronësinë**, duke normuar pronësinë private dhe pronësinë mbi pasuritë natyrore dhe të mirat në përdorim të përgjithshëm. Paragrafi i parë normon të drejtën për gëzim të pronësisë, si dhe kushtet e arsyet për privim apo kufizim të saj, ngjashëm si në Kosovë dhe vendet përreth. Në raport me të dytën, kushtetutëbërësi malazez kufizohet vetëm në konstatimin solemn se pasuritë natyrore dhe të mirat në përdorim të përgjithshëm i takojnë Shtetit malazez.

Neni 59 i **KMZi** garanton **të drejtën e ndërmarrësisë**, si një të drejtë të veçantë, duke dhënë në mënyrë shteruese edhe arsyet dhe kushtet që mund të çojnë në kufizimin e saj. Në asnjë rast individët nuk mund të privohen nga kjo e drejtë, e cila vetëm mund të kufizohet në kushtet dhe për arsye të vëna nga kushtetutëbërësi. Ato arsye dhe kushte për kufizim kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, mjedisit jetësor, pasurive natyrore dhe trashëgimisë kulturore ose sigurisë e mbrojtjes së **Malit të Zi** (neni 59.2).

E drejta e trashëgimit garantohet në një nen të vetëm, që ka vetëm një dispozitë (neni 60), që më pas pasohet nga të drejtat e të huajve për të qenë subjekt i të drejtave pronësore sipas kushteve të përcaktuara me ligj (neni 61).

E drejta për punë, përfshinë katër komponentë: të drejtën për punë në kuptimin e ngushtë të fjalës; të drejtën për zgjedhje të profesionit e punësimit; të drejtën për kushte humane të punës dhe, së fundi, të drejtën për mbrojtje gjatë kohës së papunësisë (neni 62). **Ndalohet puna e detyrueshme**, në ndërkohë që kushtetutëbërësi vetë i ka përcaktuar situatat kur nuk bëhet fjalë për punë të detyrueshme (neni 63). **Të drejtat e të punësuarve** normohen me nenin 64 dhe përfshijnë: të drejtën për fitim përkatës, kohë të kufizuar të punës dhe pushim me pagesë, mbrojtje në punë dhe mbrojtjen e posaçme në punë të kategorive të caktuara (gratë, rinia dhe invalidët). Neni 65 rregullon Këshillin Social, që harmonizon pozitën sociale të të punësuarve dhe përbëhet nga përfaqësuesit e sindikatave, punëdhënësve dhe Qeverisë. **E drejta për grevë** e të punësuarve garantohet, por jo për të gjithë. Kjo e drejtë nuk u takon ushtarëve,

policëve, të punësuarve në organet shtetërore dhe shërbimet publike, me qëllim të mbrojtjes së interesit publik dhe sipas mënyrës së përcaktuar me ligj (neni 66). **Sigurimi social** garantohet për të gjithë të punësuarit, kurse Shteti ka për detyrim t'i sigurojë materialisht personat e paaftë për punë që nuk kanë mjete për jetesë (neni 67). Invalidët gëzojnë mbrojtje të posaçme (neni 68). **Mbrojtja shëndetësore** garantohet për çdo person, kurse në mënyrë të posaçme për fëmijët, gratë shtatzëna, personat e moshuar dhe invalidët, përveç rasteve kur mbrojtjen shëndetësore këta persona e realizojnë mbi ndonjë bazë tjetër (69). Mbrojtja e konsumatorit është një e drejtë e ndarë, që nuk haset në tri kushtetutat e shtjelluara më sipër, e cila garantohet për çdo kënd sa i përket këtyre ndalesave: ndalimit të ndërmarrjes së veprimeve që cenojnë shëndetin, sigurinë dhe privatësinë e konsumatorit (neni 70).

Martesa dhe familja gjenden të normuara me nenet 70 dhe 71 të **KMZi**. Në nenin 71 bëhet e qartë se martesa ka të bëjë me personat e gjinisë së kundërt, pra bëhet fjalë për definim tradicional, të cilin e hasim në mjaft kushtetuta dhe ngjason me definimet ligjore të martesës (neni 70.1). Bashkëshortëve të definuar në bazë të gjinisë biologjike iu garantohet barazia (neni 70.2). **Familja** gëzon mbrojtje të posaçme (neni 71.1), kurse prindërit janë të detyruar të përkujdesen për edukimin dhe shkollimin e fëmijëve (neni 71.2). Një detyrim specifik ekziston për fëmijët, të cilët kanë detyrim kushtetues për përkujdesje ndaj prindërve të moshuar që janë në nevojë për ndihmë (neni 72.3). Në fund bëhet e qartë se fëmijët e lindur në martesë janë të barabartë me fëmijët që kanë lindur jashtë martesës (neni 72.4). **Mbrojtja e nënës dhe fëmijës** bëhet me nenin 73, ku Shtetit i vihet një detyrë e posaçme për të vënë në jetë këtë mbrojtje. **Të drejtat e fëmijës** normohen me nenin në vijim, në dy paragrafë: i pari thotë se fëmija gëzon të drejta në pajtim më pjekurinë dhe moshën që ka, kurse i dyti i garanton fëmijës mbrojtje e veçantë nga abuzimi ose shfrytëzimi psikik, fizik dhe ekonomik.

Nga marrëdhëniet familjare kalohet në marrëdhëniet që lidhen me arsimin dhe krijimtarinë humane. Neni 75 i **KMZi** garanton të **drejtën për arsimin**, e bën të detyrueshëm dhe pa pagesë shkollimin fillor dhe garanton autonominë e universitetit dhe institucioneve të tjera të arsimit të lartë dhe shkencës. **Liria e krijimit** normohet me nenin në vijim, dhe përfshinë krijimtarinë shkencore, kulturore dhe artistike. Gjithashtu, në këtë nen garantohet botimi i veprave dhe të arriturave shkencore e artistike, i zbulimeve shkencore dhe teknike, kurse autorëve të tyre të drejtat pasurore dhe jopasurore. Neni 77 është një dispozitë që ka natyrën e zotimit te Shtetit malazez kundrejt shkencës, kulturës dhe artit, zhvillimin e të cilave e nxit, mbron dhe promovon.

Detyrimi i secilit për të ruajtur trashëgiminë natyrore dhe kulturore me interes të përgjithshëm figuron në paragrafin e parë të nenit të fundit të seksionit mbi këtë kategori të lirive dhe të drejtave të njeriut, që përfshinë edhe detyrimin e Shtetit për të mbrojtur trashëgiminë natyrore dhe kulturore (neni 78.2).

7.3.4. Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut në Serbi

Edhe në **KSerb**, pjesa e dytë i kushtohet lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve (nenet 18-81). Njëjtë si në **KMZi**, në kuadër të pjesës së dytë normohen edhe të drejtat e posaçme të pakicave (nenet 75-81). Kjo pjesë nis me parimet e përgjithshme, njëjtë si në kushtetutat tjera përreth, përveç **KKos**. Në **KKSerb**, megjithatë, nuk bëhet ndarja e lirive dhe të drejtave të njeriut sipas gjeneratave nëpër seksione të posaçme, njëjtë si në **KKos**. Kjo nuk do të thotë se **KSerb** nuk i normon tri kategoritë standarde të lirive dhe të drejtave të njeriut.

Në pjesën e përgjithshme të pjesës së dytë ngërthehen parimet themelore. Si parim i parë themelor është parimi i zbatimit të drejtpërdrejtë të lirive dhe të drejtave të garantuara me **KSerb**. Ky zbatim përfshinë edhe liritë dhe të drejtat e garantuara me rregulla përgjithësisht të pranuara të së drejtës ndërkombëtare (zakonet ndërkombëtare), marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara dhe ligje (neni 18 parag.1 & 2). Me ligj mund të përcaktohet mënyra e realizimit të këtyre të drejtave por vetëm nëse një gjë e tillë shprehimisht përcaktohet me **KSerb** ose për shkak se natyra e ndonjë të drejte imponon nxjerrjen e ligjit.

Sidoqoftë, ligji që nxirret për skicimin e mënyrës së realizimit të të drejtave nga ky nen nuk guxon në asnjë mënyrë të ndikojë në esencën (thelbin) e së drejtës së garantuar kushtetuese (neni 18 parag. 3). Dispozita e katër e këtij neni, dhe e fundit, ka karakter udhëzues sa i përket standardit të interpretimit të pjesës së dytë të **KSerb**: dispozitat mbi liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve interpretohen në favor të përparimit të vlerave të shoqërisë demokratike, në pajtim me standardet ndërkombëtare në fuqi mbi liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, si dhe në pajtim me praktikën e institucioneve ndërkombëtare që mbikëqyrin realizimin e tyre. Kjo praktikisht dhe në rend të parë nënkupton praktikën e **GJEDNJ-së**, si një institucion evropian që mbikëqyr realizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe në të cilin Serbia është shtet anëtar me të drejta të plota.

Neni 19 në një paragraf të vetëm dhe të gjatë jep qëllimin e garancioneve kushtetuese. Ky qëllim lidhet për ruajtjen e dinjitetit të njeriut dhe realizimin e lirisë dhe barazisë së plotë të secilit individ, në një shoqëri të drejtë, të hapur dhe demokratike që bazohet në sundimin e së drejtës. Ky nen sanksionon një qasje liberale ndaj lirive dhe të drejtave të njeriut, me fokus në dinjitetin, lirinë dhe barazinë e njeriut. Kufizimet e lirive dhe të drejtave të njeriut normohen në nenin 20, i cili u diskutua më sipër. Neni 21 ndalon diskriminimin, me terma afërsisht të njëjtë me kushtetutat e vendeve të tjera përreth. Neni 22 garanton mbrojtjen gjyqësore të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të minoriteve në rast të cenimit apo kufizimit të tyre. Këtë mbrojtje e garanton edhe pranë institucioneve ndërkombëtare, ngjashëm si në **KMZi**. Me këtë përfundojnë dispozitat e parimeve themelore.

Ani se pa e cekur në titull të seksionit, normimi nis me **liritë dhe të drejtat personale**, vazhdon me **liritë dhe të drejtat politike** dhe me **liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore**. Liritë dhe të drejtat e minoriteteve normohen në seksionin e fundit të pjesës së dytë. As ne nuk kemi bërë ndarjen e zakonshme, por do t'i trajtojmë ashtu siç janë dhënë nga kushtetutëbërësi serb me radhë.

Neni 23 mban titullin "Dinjiteti dhe zhvillimi i lirë i personalitetit". Në paragrafin e parë dinjiteti konsiderohet si i pacenueshëm dhe të gjithë duhet ta respektojnë dhe mbrojnë. Më këtë redaktim, megjithatë, dinjiteti nuk vihet në korelacion me secilën liri dhe të drejtë njerëzore, siç e bën **KKos**. Zhvillimi i lirë i personalitetit nuk mund të cenojë të drejtat e garantuara kushtetuese të të tjerëve, thuhet në paragrafin e dytë të këtij neni. E drejta për jetë garantohet në nenin 24, në tre paragrafë: i pari konstaton se jeta e njeriut është e paprekshme; i dyti thotë se në **Serbi** nuk ka dënim me vdekje; dhe, i treti, njëjtë si në **KMZi**, ndalon klonimin e qenieve njerëzore. Neni në vijim garanton integritetin fizik dhe psikik. Edhe këtu bëhet fjalë për mbrojtje nga tortura, trajtimi ose dënimi çnjerëzor dhe poshtërues si dhe për mbrojtje nga kontrollet ose eksperimentet mjekësore apo shkencore, pa pëlqimin e dhënë shprehimisht. Ndalimi i skllavërisë ose gjendjeve të ngjashme me robërinë dhe puna e detyruar rregullohen në një nen të njëjtë, nenin 26, me përmbajtje afërsisht të njëjtë me kushtetutat e vendeve përreth Serbisë.

Çështjet që lidhen me **lirinë dhe sigurinë** (privimi nga liria, kushtet dhe arsyet, kohëzgjatja dhe kështu me radhë), normohen në mënyrë më të saktë se në kushtetutat përreth Kosovës dhe atë në nenet 27-30. Në fillim, në nenin 27, pas garantimit të lirisë dhe sigurisë së individit, kushtetutëbërësi serb jep arsyet, mjetet dhe procedurat e privimit nga liria dhe liritë dhe të drejtat që gëzojnë personat e privuar nga liria. Neni 28 sanksionon mënyrën e sjelljes ndaj personit të privuar nga liria, dhe kërkohet shprehimisht sjellja njerëzore, ndalimi i përdorimit të dhunës, nxjerrjes së deklaratave me dhunë dhe vetëfajësimi. Neni 29 rregullon të drejtat shtesë të personave të privuar nga liria pa vendim të gjyqit, duke përcaktuar kohën prej 48 (dyzetëetetë) orëve si maksimum që mund të zgjatë ky privim. Në këtë kohë, personit të privuar nga liria duhet t'i tregohet se ka të drejtë të mos deklarohet fare dhe të drejtën për caktim të një mbrojtësi sipas zgjedhjes, ose të caktuar nga gjykata. Nëse për 48 orë nuk vendoset fati i personit të privuar nga liria pa vendim të gjyqit, ajo ose ai lirohet. Neni 30 rregullon paraburgimin, në mënyrë shumë më të qartë se në kushtetutat e vendeve përreth, duke i dhënë garancion të fortë kushtetuese, i cili konsiston me sa vijon: një, paraburgimi mund të ndodhë vetëm nëse ekziston dyshimi i bazuar se personi privuar nga liria ka kryer vepër penale; dy, kjo mund të bëhet vetëm nëse kjo nevojitet për zhvillimin

e procedurës penale; tre, nëse personi paraburgosur nuk është marrë në pyetje me rastin e marrjes së vendimit, ose nëse vendimi për paraburgim nuk është ekzekutuar, atëherë ajo/ai duhet të dërgohet para gjykatës kompetente dhe më pastaj të caktohet paraburgimi, brenda afatit prej 48 (dyzetëetetë) orëve; katër, vendimi me shkrim dhe i arsyetuar për paraburgim i dërgohet personit të paraburgosur brenda dymbëdhjetë orëve, i cili ka të drejtë ankese; së fundi, vendimin për ankesën e bie gjykata brenda afatit prej 48 (dyzetëetetë) orëve. Edhe kohëzgjatja e paraburgimit është shumë më e qartë se në vendet përreth Kosovës, përfshirë vetë **KKos**. Neni 31 flet për këtë, në tre paragrafë. Në paragrafin e parë, caktohet maksimumi prej gjashtë muajve për zgjatjen e paraburgimit, në shkallë të parë dhe në shkallë të dytë. Nëse nuk ngrihet aktakuza për gjashtë muaj, i paraburgosuri lirohet. Pas ngritjes së aktakuzës, koha e paraburgimit duhet të jetë sa më e shkurtër, por kjo rregullohet me ligj (neni 31.2). Së fundi, në paragrafin e tretë garantohet mbrojtja në liri, që nga momenti kur pushojnë arsyet për të cilat është caktuar paraburgimi. E drejta në gjykim të drejtë normohet me nenin 32 dhe nuk ka ndonjë dallim me kushtetutat e vendeve fqinje me **Kosovën**. E njëjta vlen edhe për të drejtat e posaçme të të pandehurit/akuzuarit, që gjenden në nenin 33. Neni 34, nën emërtimin "Siguria juridike në të drejtën penale" rregullon parimin e legalitetit të veprës dhe dënimit, parimin **ne bis in idem** dhe ndalimin e parashkrimit të veprave penale që janë krim lufte, gjenocid dhe krim kundër njerëzimit. Njëjtë si në **KMZi**, në nenin 35 rregullohet e drejta e kompensimit të dëmit të shkaktuar me privim të paligjshëm të lirisë, paraburgim të paligjshëm dhe dënim të paligjshëm. Kjo e drejtë përfshinë edhe rehabilitimin dhe të drejtat tjera.

E drejta për mbrojtje të barabartë të të drejtave dhe e drejta në mjet juridik (neni 36). Ky formulim i kësaj të drejte është më i ndryshëm në KSerb dhe ka një përmbajtje më të saktë se në kushtetutat e vendeve përreth. Paragrafi i parë garanton mbrojtjen e të drejtave para gjyqeve dhe pranë të gjitha instancave të tjera të pushtetit, kurse i dyti garanton të drejtën e ankesës ose të mjetit tjetër juridik, çdo herë kur vendoset për të drejtat, detyrime ose interesat individuale. Për këto të fundit, kushtetutëbërësi kërkon që të kenë mbështetje ligjore, pra interesat si koncept, për të qenë objekt i mbrojtjes së kësaj dispozite duhet të jenë të përcaktuara me ligj. **E drejta për subjektivitet juridik** është një e drejtë specifike që nuk haset në kushtetutat e vendeve përreth (neni 37). Kjo e drejtë i takon çdo personi. Me mbushjen e moshës madhore, që është tetëmbëdhjetëvjeçare, personi fiton zotësinë e veprimit, përkatësisht zotësinë që në mënyrë të pavarur të vendos për të drejtat dhe detyrime vetjake (parag.2). Përzgjedhja dhe shfrytëzimi i emrave personalë dhe emrave të fëmijëve vetjakë janë të lira (parag.3). Pas kësaj të drejte pason **e drejta për shtetësi** (neni 38), fitimi ose humbja e së cilës normohet me ligj (parag. 1). Edhe këtu garantohet e drejta e shtetasve serbë për mosdëbim e as e drejta për mosprivim të shtetësisë serbe dhe nga e drejta për ndryshimin e saj (parag.2). Lindja në territorin serb konsiderohet kusht i mjaftueshëm për fitimin e shtetësisë, përveç rasteve kur plotësohen kushtet për fitimin e shtetësisë së një shteti tjetër.

Liria e lëvizjes garantohet me nenin 39 të KSerb. Kjo përfshinë të drejtën e lëvizjes së lirë, vendosjes, largimit dhe kthimit në territorin e Serbisë (parag. 1). Në këtë nen, ligjvënësit i jepet një autorizim i gjerë për implementimin e kësaj të drejte kushtetuese, në ndërkohë që kufizimi i saj përcaktohet qartë me të (për shkak të zhvillimit të procedurës penale, mbrojtjes së rendit dhe qetësisë publike, pengimit të zgjerimit të sëmundjeve ngjitëse apo mbrojtjes së vendit) (parag. 2). Hyrja e të huajve dhe lëvizja e tyre në Serbi normohet me ligj, i cili përcakton edhe situatat dhe kushtet nën të cilat i huaji mund të dëbohet nga ky vend fqinj i Kosovës, gjithnjë duke pasur parasysh mosdiskriminimin dhe mosvënien në rrezik të jetës, lirive dhe të drejtave të të hujave që garantohen me KSerb (parag.3).

Paprekshmëria e banesës normohet në nenin 40, në tre paragrafë. I pari thotë shumë shkurt se banesa është e paprekshme. I dyti konstaton se me vendim gjyqësor mund të futet në banesën e huaj apo hapësira të tjera, edhe pa pëlqimin e mbajtësit të tyre, me qëllim që të kryhet bastisja. Edhe këtu kërkohet prania e dy dëshmitarëve kur të hyhet në banesë pa pëlqimin e mbajtësit, apo në hapësira të tjera, por me vendim të gjyqit. Nëse mbajtësi nuk është prezent, ose përfaqësuesi i saj/tij, atëherë dy dëshmitarë madhorë mund të prezantojnë gjatë bastisjes (parag. 2). Në rastet e veçanta, kur kërkohet privimi nga

liria i kryesit të veprës penale apo largimit të rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për njerëz dhe pasurinë, mund të ndodh bastisja edhe pa vendim gjyqi. Por, mënyra e hyrjes në banesë dhe e bastisjes në raste të tilla përcaktohet me ligj (parag. 3). Ky standard pak a shumë është i njëjtë si në kushtetutat e vendeve përreth, siç është edhe ai i garantimit të paprekshmërisë së letrave dhe korrespondencës tjetër nga neni 41, në të cilin gjithashtu jepen arsyet e interesit të përgjithshëm si shkak për shmangie nga zbatimi i këtij standardi. Të dhënat personale mbrohen me nenin 42, edhe këtu sipas standardit afërsisht të njëjtë si në vendet tjera përreth, ku shmangiet nga zbatimi i tij janë saktësisht të vëna në KSerb. Të dhënat personale mbrohen me nenin 42, ashtu që ndalohet përdorimi i tyre përveç për qëllimin për të cilin janë mbledhur (parag.3). Edhe këtu sipas standardit afërsisht të njëjtë si në vendet tjera përreth, ku shmangiet nga zbatimi i tij janë saktësisht të vëna nëpër kushtetuta dhe kanë të bëjnë me interesin e përgjithshëm (zhvillimi i procedurës penale dhe siguria e vendit).

Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë normohet në nenin 43. Sikundër u tha, kushtetutëbërësi serb nuk i ka ndarë liritë dhe të drejtat e njeriut, përveç atyre që u takojnë minoriteteve. Siç shihet, liritë dhe të drejtat politike nisin më nenin 43. Ky nen shumë është i ngjashëm në përmbajtje me nenet e kushtetutave të vendeve përreth Kosovës. Në **KSerb**, megjithatë, ekziston një dispozitë unike që nuk gjendet në kushtetutat tjera përreth: në paragrafin e fundit të nenit 43 njihet e drejta e prindërve dhe e kujdestarëve ligjorë për t'iu siguruar fëmijëve arsimin moral dhe fetar në pajtim me bindjet e tyre. Kjo dispozitë kushtetuese mund të shërbejë si bazë juridike për indoktrinim fetar të fëmijëve dhe të miturve të tjerë. Kishat dhe bashkësitë fetare normohen me nenin në vijim, nenin 44. Në paragrafin e parë të tij garantohet barazia e kishave me bashkësitë tjera fetare dhe janë të ndara nga shteti. Në paragrafin e dytë, njëjtë si në vendet përreth garantohet autonomia e brendshme e bashkësive fetare. Ato kanë të drejtë të krijojnë institucione dhe shkolla fetare, me karakter bamirës dhe social dhe t'i drejtojnë ato në pajtim me ligjin. Për dallim nga vendet tjera, **KSerb** i jep të drejtë Gjykatës Kushtetuese për të ndaluar bashkësinë fetare atëherë kur veprimtaria e saj cenon të drejtën për jetë, të drejtën për shëndet psikik dhe fizik, të drejtat e fëmijës, të drejtën në integritet personal dhe familjar, të drejtën për pronë, sigurinë dhe rendin publik dhe kur nxitë dhe shkakton jotolerancë fetare, nacionale ose racore (parag.3).

Kundërshtimi i ndërgjegjes afërsisht ka përmbajtje të njëjtë me vendet përreth, me përjashtim që këtu shprehimisht përmendet detyrimi ushtarak, nisur nga fakti se në Serbi ai akoma është i detyrueshëm. Kjo do të thotë se dispozita e nenit 45 të **KSerb** mbi kundërshtimin e ndërgjegjes në rend të parë mbron personat që janë në shërbim ushtarak, sepse tërë neni flet për shërbimin ushtarak dhe të drejtën e personave për të kundërshtuar bartjen e armëve. Kjo është ndryshe në **KMZi**, e cila përfshinë edhe kundërshtimin e ndërgjegjes për çështjet tjera që nuk lidhen vetëm me detyrimin ushtarak, kurse në **KKos** kjo e drejtë është pjesë e lirisë së besimit, ndërgjegjes dhe fesë dhe ekskluzivisht ka të bëjë me mbrojtjen e individëve nga imponimin kundër ndërgjegjes së tyre të fesë ose besimeve të llojit të caktuar. Për dallim nga **KKos** dhe **KMZi**, në **KSerb** liria e mendimit dhe e shprehjes janë normuar me një nen, nenin 46. Përmbajtja e kësaj të drejte, megjithatë, në thelb nuk ndryshon nga vendet përreth. Një liri e veçantë e shprehjes normohet me nenin 47 - liria e shprehjes së përkatësisë nacionale. Edhe kjo dispozitë ka përmbajtje të njëjtë me dispozitat e vendeve fqinje që normojnë liritë dhe të drejtat e minoriteteve, me një dallim që në KSerb theksi vihet te diversiteti nacional dhe garantimi i tij. Kjo nuk do të thotë se me **KSerb** nuk garantohet diversiteti tjetër, gjë që shihet nga redaktimi i nenit të saj 48 që garanton nxitjen e respektimit të dallimeve etnike, kulturore, gjuhësore dhe fetare dhe e mirëkuptimit të tyre. Në funksion të ruajtjes së këtij diversiteti është futur dispozita e nenit 49, që ndalon nxitjen e urrejtjes racore, nacionale dhe fetare.

Liria e medies, si një e drejtë e veçantë, normohet me nenin 50, pasuar nga garantimi i të drejtës për informim (neni 51). Edhe këtu substanca e garancioneve kushtetuese lidhur me këto dy të drejta është e njëjtë me vendet përreth, ani pse bëhet në mënyra të ndryshme.

Të drejtat zgjedhore nisin të shfaqen në nenin 52, dhe përfshijnë të drejtën aktive dhe pasive zgjedhore. Mbrojtja juridike e të drejtave zgjedhore bëhet me ligj, thotë paragrafi i fundit i këtij neni, në ndër-

kohë që paragrafi pararendës, paragrafi i dytë, shpallë të garantuar të drejtën e përgjithshme të votës, të lirë, të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë. Për nga natyra, e përafërt me këtë është një e drejtë tjetër - e drejta për pjesëmarrje në drejtimin me punët publike (neni 53). Kjo e drejtë, megjithatë, është ndryshe nga të drejtat zgjedhore sepse përfshinë të drejtën për drejtim të punëve publike në kushte të barabarta, siç janë futja në shërbime publike dhe funksione publike. Këtu, pra, nuk bëhet fjalë për të drejtat zgjedhore si më sipër, por për të drejtën për të udhëhequr punët publike në çdo aspekt, nën kushtet e barabarta me të tjerët.

Liria e tubimit, me përmbajtje shumë të njëjtë si në vendet përreth, gjendet në nenin 54 të **KSerb**, ku gjithashtu ligjvënësit i jepet autorizim i madh për operacionalizimin e saj në praktikë. E njëjta vlen edhe për lirinë e asociimit nga neni 55. **E drejta e peticionit** përbën një të drejtë të re, që gjendet në KMZi, por jo në KKos: përmbajtja e saj në nenin 56 të KSerb është e ngjashme me KMZi dhe lidhet me të drejtën e individëve, individualisht ose në grup, për t'iu drejtuar organeve shtetërore dhe autoriteteve publike për çfarëdo çështje qoftë dhe të merr përgjigje për këtë. U mor vesh, edhe këtu kjo e drejtë nuk mund të përbëjë vepër penale, për çka ekziston përgjegjësia. Ndryshe, askush nuk përgjigjet për ushtrimin e kësaj të drejte kushtetuese.

E drejta e azilit (neni 57) nuk dallon nga vendet tjera përreth, si në përmbajtje ashtu edhe në autorizimin ligjor për normimin e mënyrës së realizimit, mohimit dhe kufizimit të saj.

Të drejtat dhe liritë ekonomike, sociale dhe kulturore nisin me **të drejtën për pronë** (neni 58), që normohet afërsisht njëjtë si në vendet tjera. Kjo e drejtë pasohet nga **e drejta e trashëgimit** (neni 59), e cila gjithashtu është shumë e ngjashme me zgjidhjet kushtetuese malazeze. Nuk dallon shumë nga **KMZi** as normimi serb i të **drejtës për punë** me të gjithë përbërësit e saj (neni 60) dhe **të drejtës për grevë** (neni 61).

E drejta për lidhje të martesës dhe barazia e bashkëshortëve rregullohet me nenin 62. Edhe këtu, si në **Mal të Zi**, bëhet fjalë për martesën që definohet sipas gjinive biologjike, një burrë e një grua. Bashkësia jashtëmartesore barazohet me bashkësinë martesore në plotësi. KSerb garanton vendimmarrje të lirë për lindjet (neni 63), si në vendet përreth, si dhe të drejtat e fëmijëve (neni 64), gjithashtu në mënyrë shumë të ngjashme me vendet tjera në fqinjësi. Të drejtat dhe detyrat e prindërve janë objekt normimi i nenit 65. Edhe këtu, fokusi vihet te mbrojtja e interesit më të mirë të fëmijëve. Familja, nëna, prindërit ushqyes dhe fëmijët gëzojnë mbrojtje të veçantë edhe në KSerb (neni 66).

E drejta për ndihmë juridike rregullohet me nenin 67, dhe përfshinë si ndihmën që ofron avokatura ashtu edhe atë që ofrojnë shërbimet pranë njësive të vetëqeverisjes lokale, në pajtim me ligjin, i cili cakton edhe rastet kur ndihma juridike është pa pagesë.

Mbrojtja shëndetësore rregullohet në nenin 68 dhe është shumë iu ngjashëm me KMZi, si sa i përket kategorive të posaçme që gëzojnë këtë të drejtë, ashtu edhe sa i përket mënyrës së sigurimit të fondeve publike për realizimin e kësaj të drejte. E njëjta vlen edhe për mbrojtjen sociale nga neni 69 dhe sigurimin pensional nga neni 70.

E drejta për arsimin gjendet në nenin 71, me përmbajtje të ngjashme si në vendet tjera, kurse **autonomia e universitetit dhe institucioneve të arsimit të lartë dhe institucioneve shkencore** garantohet në mënyrë të posaçme me nenin 72, shumë ngjashëm me zgjidhjet kushtetuese në Mal të Zi. **Garantohet liria e krijimtarisë shkencore dhe artistike** (neni 73), ku Serbia mban një përgjegjësi të posaçme për realizimin e kësaj të drejte, njëjtë si në Kosovë dhe vendet përreth.

E drejta për ambient të shëndosh sanksionohet me nenin 74, duke i vënë Serbisë si shtet një detyrim të veçantë për realizimin e kësaj të drejte, por edhe individëve të zakonshëm. Me këtë të drejtë mbyllet

seksioni i lirive dhe të drejtave individuale në KSerb.

Sikundër shihet, KSerb ka ngjashmëri më të madhe me KMzi dhe KKos, sa i përket lirive dhe të drejtave të njeriut. Për dallim nga KKos, megjithatë, në KSerb, njëjtë si në **KMZi,** në kuadër të pjesës së dytë normohen edhe të drejtat e posaçme të pakicave (nenet 75-81), kurse Avokati i Popullit normohet në pjesën e pestë ("Rregullimi i pushtetit"), seksioni 5 ("Mbrojtësi i qytetarëve"), vetëm në një nen – nenin 138.

Njëjtë si në vendet tjera përreth, sikundër shihet, bazat për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të pakicave gjenden në dispozitat kushtetuese që në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me mbrojtjen e tyre. Ato gjithashtu gjenden edhe në dispozitat kushtetuese dhe ligjore mbi kompetencat e organeve shtetërore në të gjitha nivelet.

Sa i përket mekanizmit mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të pakicave, edhe **KSerb** njeh mbrojtjen gjyqësore, mbrojtjen pranë **Gjykatës Kushtetuese** dhe mbrojtjen nga **Avokati i Popullit.** Mbrojtja fillestare bëhet pranë gjykatave të rregullta dhe më pas në Gjykatën Kushtetuese (neni 22 lidhur me nenin 170). Për vënien në lëvizje të procedurave pranë Gjykatës Kushtetuese, edhe KSerb kërkon shterrjen e mjeteve juridike efektive, në një mënyrë afërisht të njëjtë me kushtetutat e vendeve përreth. Kjo radhitje e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave natyrshëm del në syprinë, për shkak se një pjesë e posaçme e **KSerb**, pjesa e tetë, i kushtohet kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, njëjtë si në **KMZi.**

Ngjashmëria me KMZi vërehet edhe në dispozitat e përgjithshme të pjesës së dytë të KSerb, që normojnë liritë dhe të drejtat e njeriut: neni 18 që në fillim tregon se Kushtetuta, zakonet dhe marrëveshjet ndërkombëtare janë bazë themelore për realizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Më pas ndalohet diskriminimi dhe promovohet barazia para ligjit, pa marrë parasysh cilësitë ose vetitë e caktuara personale (neni 21).

Në nenin 18.4, **KSerb** përmban garancione shprehimore kushtetuese për qytetarët e vendit për të shfrytëzuar mekanizmat juridikë dhe gjyqësorë ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Kjo nënkupton se shtetasit e Serbisë kanë të drejtë të shfrytëzojnë të gjitha mekanizmat regjionalë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre, ku vendi i tyre është palë kontraktuese. Kjo është situatë e njëjtë që ekziston në të gjitha vendet përreth Kosovës, përveç vetë **Kosovës.**

Sipas **KSerb**, **Avokati i Popullit** ndërmerr masa për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe mbikëqyr punën e organeve të administratës shtetërore dhe institucioneve e organizatave që ushtrojnë autorizime publike (neni 138 parag. 1). Avokati nuk ka të drejtë ta kontrollojë punën e organeve qendrore shtetërore (Presidentit, Kuvendit, Qeverisë, Prokurorisë dhe gjyqeve, Gjykatës Kushtetuese) (neni 138.2). Mbrojtja që ofron ky organ, njëjtë si në vendet përreth, nuk është mbrojtje juridike. Kjo sepse vendimet e marra në vijim të mbrojtjes së të drejtave, lirive dhe interesave individuale nuk e kanë fuqinë ekzekutive (nuk mund të ekzekutohen me dhunë).

Sa i përket mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, sikundër shihet, konceptualisht, edhe në rastin serb nuk ka ndonjë dallim në mes të zgjidhjeve kushtetuese me vendet tjera përreth.

7.4. Detyrimet e qytetarit në Kosovë

Në **KKos** ekzistojnë **detyrime konkrete të qytetarëve**, por shumë më të pakta se liritë dhe të drejtat kushtetuese. Këto duhet të dallohen nga **detyrimi i përgjithshëm** për të respektuar liritë dhe të drejtat e tjerëve dhe nga detyrimi për respektim të **ndalesave konkrete kushtetuese**. Përveç detyrimeve që kanë të bëjnë me qytetarët, shteti ka **detyrime konkrete kushtetuese**. Edhe këtu duhen dalluar nga **detyrimi i përgjithshëm** për të mbrojtur dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore (neni 21.3). Këto **detyrime konkrete kushtetuese** në barrë të shtetit, në veçanti janë të theksuara në sferën e lirive dhe të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore. Këtu shteti ka detyrim që të ofrojë mbrojtje sociale dhe shëndetësore,

mbrojtje në rast të papunësisë, ka detyrim që të mundësojë dhe organizojë fitimin (marrjen) e arsimimit adekuat, të nxisë qytetarët për tolerancë dhe të kujdeset për zhvillim. Në disa vende që janë fqinjë me **Kosovën**, në këto detyrime të shtetit futet edhe detyrimi për të nxitur natalitetin dhe zhvillimin regjional të vendit.

Nisur nga e përgjithshmja (induksioni) kah individualja (deduksioni), mund të thuhet se çdo e drejtë e liri krijon njëkohësisht një detyrim për të tjerët. Kjo është esenca e dispozitës së nenit 21.3 të **KKos**, që përcakton **detyrimin e përgjithshëm**, ku thuhet si vijon: "çdo kush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve". Kjo dispozitë është një orientues për çdo analizë të dispozitave që ngërthejnë detyrime konkrete kushtetuese. Si detyrime konkrete kushtetuese janë, ta zëmë, e drejta për pacenueshmërinë e banesës, e cila është, në të njëjtën kohë, detyrim për krejt të tjerët që mos të cenojnë këtë të drejtë, përfshirë këtu Shtetin; ekzistojnë liri dhe të drejta konkrete që në një mënyrë negative përcaktojnë detyrimin përkatës kushtetues: e drejta e çdo pjesëtari të komunitetit që të zgjedhë lirisht nëse do të trajtohet ose të mos trajtohet si pjesëtar i komunitetit, ngërthen detyrimin kushtetues që ndalon çdo detyrim për deklarim të kësaj përkatësie; një situatë e ngjashme paraqitet me të drejtat për kundërshtimin e ndërgjegjes, e cila nënkupton lirimin nga detyrimi për bartje të armës, në ato vende ku shërbimi ushtarak është i detyrueshëm; dhe kështu me radhë.

Çdo **ndalesë kushtetuese** në thelb është një detyrim kushtetues për të tjerët, që duhet të respektojnë ndalesat e tilla. Të tilla janë, ta zëmë, ndalimi i diskriminimit (neni 24.2), ndalimi i skllavërisë, pozitës së ngjashme me skllavërinë, punën e detyruar dhe trafikimi me njerëz (neni 28), ndalimi i dënimit me vdekje (neni 25) etj.

Në **KKos** ekzistojnë disa stipulime që përmbajnë **detyrime shprehimore kushtetuese**. Në rast të cenimit të tyre, megjithatë, nuk parashihet ndonjë sanksion, sepse një gjë e tillë lihet për rregullim legjislativ. Të tilla janë, ta zëmë, rastet për sa vijon: stipulimi në fjalinë e parë të dispozitës së nenit 23 të Kushtetutës, që përcakton se "dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm", dispozitë që reflekton një detyrim shprehimor kushtetues për respektim pa kusht të dinjitetit të njeriut; e njëjtë me këtë është e drejta që gëzojnë fëmijët për mbrojtje dhe kujdes të domosdoshëm për mirëqenien e tyre (neni 50.1) dhe detyra kushtetuese që të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve (neni 50.4) (në disa vende fqinje me Kosovën ekziston detyra kushtetuese e prindërve për të mbajtur, edukuar dhe arsimuar fëmijët e tyre); detyrimi i ndjekjes së shkollimit fillor, në të njëjtën kohë është edhe detyrim i prindërve për këtë shkollim (neni 47.1); e drejta për ambient të shëndosh është njëkohësisht një detyrim kushtetues për organet e pushtetit dhe individët: çdokush, në veçanti shteti dhe organet e tij janë të detyruar për të mbrojtur mjedisin jetësor (neni 52); ngjashëm me këtë duket detyrimi që ka çdo kush për të mbrojtur bukuritë e rralla natyrore, trashëgiminë shkencore, kulturore dhe historike, si dhe të mirat e interesit të përgjithshëm (detyrim të posaçëm këtu ka Republika e Kosovës) (neni 52.1 lidhur me nenin 122); detyrimi për pagim të tatimit dhe të ardhurave të tjera është një detyrim shprehimor kushtetues (neni 119.8) etj.

Një grup i posaçëm i **detyrimeve shprehimore kushtetuese** që kanë të bëjnë me Republikën e Kosovën gjendet në nenin 58 të **KKos**, që ka të bëjë me liritë dhe të drejtat e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre. Ato detyrime shprehimore kushtetuese kundrejt lirive dhe të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre kanë të bëjnë me sa vijon:

- sigurimin e kushteve të duhura për ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e identitetit të komuniteteve të Kosovës;
- promovimin e frymës së tolerancës, dialogut dhe pajtimit ndërmjet komuniteteve në frymën e standardeve të përcaktuara me Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe me Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave;
- ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme për të mbrojtur personat të cilët mund t'u nënshtro-

hen kërcënimeve ose veprimeve diskriminuese, armiqësisë a dhunës, si rrjedhojë e identitetit të tyre kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar;
- miratimin e masave adekuate për të promovuar barazi të plotë dhe efektive të pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore dhe pjesëmarrjen efektive të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në jetën publike dhe në vendimmarrje, masa që nuk konsiderohet se janë vepër e diskriminimit;
- ruajtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore të të gjitha komuniteteve, si pjesë përbërëse e trashëgimisë së Kosovës, me qëllim të sigurimit të mbrojtjes efektive të tërësisë së objekteve dhe monumenteve të rëndësisë kulturore dhe fetare për komunitetet;
- ndërmarrjen e veprimeve efektive kundër të gjithë atyre që pengojnë gëzimin e të drejtave të pjesëtarëve të komuniteteve, përmbajtja nga politikat ose praktikat që kanë për qëllim asimilimin, kundër vullnetit të tyre, të personave që u përkasin komuniteteve, si dhe mbrojtja e tyre nga çfarëdo veprimi që ka për qëllim një asimilim të tillë; dhe, së fundi,
- sigurimin, në baza jodiskriminuese, se të gjitha komunitetet dhe pjesëtarët e tyre mund të ushtrojnë të drejtat e tyre, të specifikuara me Kushtetutë.

7.4.1. Detyrimet e qytetarit në Shqipëri

Në **KShq** gjithashtu ekzistojnë **detyrime konkrete të qytetarëve**, të cilat janë shumë më të pakta se liritë dhe të drejtat kushtetuese. Edhe në rastin e të drejtës kushtetuese shqiptare duhet të bëhet dallimi mes **detyrimit të përgjithshëm** për të respektuar liritë dhe të drejtat e tjerëve nga detyrimi për respektim të **ndalesave konkrete kushtetuese**. Përveç detyrimeve që kanë të bëjnë me qytetarët, edhe shteti ka **detyrime konkrete kushtetuese**. Edhe këto duhet dalluar nga **detyrimi i përgjithshëm** për të mbrojtur dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore (neni 15.2 i KShq). Këto **detyrime konkrete kushtetuese** në barrë të shtetit, në veçanti janë të theksuara në sferën e lirive dhe të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore. Në fakt, në KShq ekziston kreu i posaçëm që skicon objektivat sociale që synon t'i realizojë Shteti shqiptar. Edhe në Shqipëri, shteti ka detyrim që të ofrojë mbrojtje sociale dhe shëndetësore, mbrojtje në rast të papunësisë, ka detyrim që të mundësojë dhe organizojë fitimin (marrjen) e arsimimit adekuat, të nxisë qytetarët për tolerancë dhe të kujdeset për zhvillim. Objektivat sociale, ndërkaq, shkojnë përtej kreut katër të pjesës së dytë, që garanton liritë dhe të drejtat konkrete ekonomike, sociale dhe kulturore. Ato janë skicime ideore të synimeve të Shtetit shqiptar, zotime programatike me karakter kushtetues, por që nuk mund të implementohen me rrugë gjyqësore (neni 59.2 i KShq).

Nisur nga e përgjithshmja (induksioni) kah individualja (deduksioni), mund të thuhet se çdo e drejtë e liri krijon njëkohësisht një detyrim për të tjerët. Kjo, megjithatë, për dallim nga **KKos**, nuk përcaktohet shprehimisht në **KShq**. Një gjë e tillë nënkuptohet nëse merret parasysh dispozita e nenit 15.1 të KShq., te pjesa e parimeve të përgjithshme të pjesës së dytë mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, ku thuhet si vijon: "Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. Kjo dispozitë definon esencën e rendit juridik shqiptar.

Edhe në rastin e Shqipërisë vlen parimi se çdo **ndalesë kushtetuese** është, në thelb, një detyrim kushtetues për respektim të tyre nga të tjerët (ndalimi i diskriminimit, ndalimi i skllavërisë, pozitës së ngjashme me skllavërinë, punës së detyruar dhe trafikimit me njerëz, ndalimi i dënimit me vdekje, etj. Gjithashtu, në KShq ekzistojnë një numër i madh i stipulimeve që përmbajnë **detyrime shprehimore kushtetuese**, shkelja e të cilave nuk sanksionohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke iu lënë një prerogativë e tillë ligjvënësit shqiptar.

7.4.2. Detyrimet e qytetarit në Maqedoninë e Veriut

Në **KMVer** nuk ekzistojnë dispozita të veçanta që flasin për detyrimet e qytetarit, sepse kapitulli i dytë që normon liritë dhe të drejtat e njeriut nuk posedon një pjesë të dispozitave të përgjithshme, të cilat zakonisht shërbejnë si udhëzues për interpretim dhe lexim të dispozitave që pasojnë. Kjo nuk do të thotë se në këtë vend fqinjë nuk ekzistojnë **detyrime konkrete të qytetarëve**. Ato ekzistojnë dhe janë edhe në KMVer shumë më të pakta se sa liritë dhe të drejtat kushtetuese. Për dallim nga KShq dhe KKos, në KMVer ekziston një stipulim kushtetues që absorbon të gjithë debatin lidhur me atë nëse ekzistojnë dispozita kushtetuese që flasin për liritë dhe të drejtat e qytetarit. E kemi fjalën për dispozitën e nenit 51.2, e cila gjendet në seksionin e tretë të kapitullit të dytë të KMVer, e cila rregullon garancitë e lirive dhe të drejtave të njeriut. Aty thuhet: "Secili e ka për detyrë ta respektojë Kushtetutën dhe ligjet". Kjo dispozitë absorbuese nuk liron askënd nga përgjegjësia dhe detyrimi i përgjithshëm kushtetues për të respektuar liritë dhe të drejtat e të tjerëve dhe ndalesat konkrete kushtetuese.

Përveç detyrimeve që kanë të bëjnë me qytetarët, edhe shteti ka **detyrime konkrete kushtetuese**. Kjo për faktin se në nenin 8 të KMVer, liritë dhe të drejtat e njeriut, mbrojtja dhe promovimi i tyre, shpallen si vlerë kushtetuese e rendit juridik maqedono-verior. Ky përcaktim parimor i kushtetutëbërësit të këtij vendi fqinjë konkretizohet në dispozitat konkrete nga kapitulli i dytë, kurse në seksionin e tij të tretë mbi garancionet kushtetuese të lirive dhe të drejtave të njeriut, Shtetit maqedono-verior i vihet si barrë mbrojtja e tyre përmes mekanizmave institucionale gjyqësorë dhe jashtëgjyqësorë. Krahas këtyre detyrimeve të përgjithshme të individit dhe Shtetit karshi lirive dhe të drejtave kushtetuese, edhe këtu duhen dalluar të njëjtat nga **detyrimet konkrete kushtetuese** që bien në barrë të Maqedonisë së Veriut, detyrime që në mënyrë të posaçme janë të theksuara në sferën e lirive dhe të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore. Këtu shteti ka detyrim që të ofrojë mbrojtje sociale dhe shëndetësore, mbrojtje në rast të papunësisë, ka detyrim që të mundësojë dhe organizojë fitimin (marrjen) e arsimimit adekuat, të nxisë qytetarët për tolerancë dhe të kujdeset për zhvillim. Në një vend, KMVer e vë parimin e drejtësisë sociale si bazë për angazhim të shtetit (neni 35 parag.1). apo themel të realizimit në nenin 41.2 të **KMVer** sikur i jepet shtetit një rol i posaçëm në promovimin e kontrollit të natalitetin në një drejtim të caktuar, me një formulim shumë eufemist: Republika, thuhet në këtë dispozitë, me qëllim të zhvillimit të harmonizuar ekonomik dhe social, udhëheq një politikë humane të popullimit.

Formulimi i dispozitave kushtetuese mbi liritë e të drejtat e njeriut lejon operacionin logjik të analizës indukcion-dedukcion: në secilën dispozitë që njihet një e drejtë apo liri, nënkuptohet se krijon një detyrim për të tjerët. Në disa dispozita shprehimisht përcaktohet detyrimi dhe ndalesa kushtetuese, në të tjerat ajo nënkuptohet për nga vetë natyra e lirisë dhe të drejtës që garantohet.

Në **KMVer** nuk ekziston ndonjë kategori e lirive dhe të drejtave për anëtarët e komuniteteve pakicë që jetojnë në këtë vend. **Marrëveshja e Ohrit**, e lidhur më 13 gusht 2001 në mes të shqiptarëve dhe pushtetit të Maqedonisë së Veriut të asaj kohe, me të cilën u ndal lufta dhe konflikti i armatosur mes shqiptarëve dhe forcave ushtarako-policore të këtij vendi (janar - gusht 2001), përbën një përjashtim nga kjo rregull. Me Marrëveshje u normua pozita juridiko-kushtetuese e shqiptarëve, por me efekt të kufizuar vetëm sa i përket përmirësimit të të drejtave gjuhësore dhe ofrimit të disa garancioneve të tjera (minimale) në sferën e kulturës, me qëllim të ruajtjes dhe kultivimit të identitet të tyre nacional. Meqë Marrëveshja është arritur pas luftës së përgjakshme të shqiptarëve me forcat e ushtarako-policore të këtij vendi, do të ishte krejt logjike që edhe kjo luftë të futej në kategorinë e luftërave nga neni 36 i **KMVer** dhe të gëzonte mbrojtje të posaçme ligjore. Ky, megjithatë, nuk është rasti: luftëtarët e UÇK-së ("Ushtria Çlirimtare Kombëtare"), që luftuan kundër politikave shtypëse dhe antishqiptare të kohës (janar - gusht 2001), nuk konsiderohen si luftëtarë çlirimtarë në kuptim të nenit 36 si më sipër të **KMVer**.

7.4.3. Detyrimet e qytetarit në Mal të Zi

Në nenin 10 të **KMZi** ekziston një dispozitë e çuditshme, sipas së cilës "e lirë është çdo gjë që nuk ndalohet me Kushtetutë dhe ligj". Një formulim i ngjashëm ekziston edhe në paragrafin e fundit të nenit 8 të **KMVer**. Në ndërkohë që në **KMZi** kjo dispozitë gjendet në pjesën e përgjithshme dhe mbanë titullin "Kufijtë e lirive" dhe pasohet nga dispozita tjetër që vë si detyrim respektimin e kushtetutës dhe ligjeve për çdokënd, në **KMVer** dispozita si më sipër gjendet në kuadër të dispozitave që normojnë vlerat e rendit kushtetues të këtij vendi, vlera që mbrohen nga shteti. Në **KMVer**, detyrimi për respektim të kushtetutës dhe ligjit gjendet në fund të kapitullit mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, kurse në KMZi në dispozitat themelore.

Edhe në **KMZi** ekzistojnë **detyrime konkrete të qytetarëve**, që janë shumë më të pakta se liritë dhe të drejtat kushtetuese, detyrime që gjithashtu duhet të dallohen nga **detyrimi i përgjithshëm** për të respektuar liritë dhe të drejtat e tjerëve si dhe nga detyrimi për respektim të **ndalesave konkrete kushtetuese**. Përveç detyrimeve që kanë të bëjnë me qytetarët, edhe në KMZi shteti ka **detyrime konkrete kushtetuese**. Në KMZi, megjithatë, për dallim nga KKos, nuk ekziston një dispozitë shprehimore që sanksionon një **detyrim të përgjithshëm** të shtetit për të mbrojtur dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore (neni 21.3 i KKos). Kushtetutëbërsi malazez ka zgjedhur një qasje tjetër: në nenin 17.1 të KMZi, me të cilin nisin dispozitat e përgjithshme të pjesës së dytë mbi liritë dhe të drejtat themelore, jepen bazat e realizimit të lirive dhe të drejtave kushtetuese. Liritë dhe të drejtat e njeriut realizohen në bazë të Kushtetutës dhe marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, thuhet në dispozitën e sipërcekur të nenit në fjalë. Sa i përket **detyrime konkrete kushtetuese** që i vihen në barrë shtetit, ndërkaq, edhe në Mal të Zi ato janë të theksuara në veçanti në sferën e lirive dhe të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore: edhe këtu shteti ka detyrim që të ofrojë mbrojtje sociale dhe shëndetësore, mbrojtje në rast të papunësisë, ka detyrim që të mundësojë dhe organizojë fitimin (marrjen) e arsimimit adekuat, të nxisë qytetarët për tolerancë dhe të kujdeset për zhvillim. Në **KMZi** është edhe më shprehimor se në **Maqedoninë e Veriut** detyrimi i shtetit për promovim dhe nxitje të natalitetit: Shteti krijon kushtet me të cilat nxitet lindja e fëmijëve, thuhet në dispozitën e nenit 73 parag. 2 të KMZi.

7.4.4. Detyrimet e qytetarit në Serbi

Në **KSerb** nuk gjenden dispozitat e çuditshme, si në KMZi dhe KMVer, që shpallin të lejueshme çdo gjë që nuk ndalohet me kushtetutë e me ligje. Në mënyrë të ngjashme me **KKos**, në nenin 23 parag. 1 të **KSerb dinjiteti i njeriut** merret si themel i lirive dhe të drejtave të njeriut, të cilin të gjithë duhet ta respektojnë.

Nga leximi i pjesës së dytë të **KSerb**, qartë shihet se edhe aty ekzistojnë **detyrime konkrete të qytetarëve**, që janë shumë më të pakta se liritë dhe të drejtat kushtetuese, detyrime që gjithashtu duhet të dallohen nga **detyrimi i përgjithshëm** për të respektuar liritë dhe të drejtat e tjerëve si dhe nga detyrimi për respektim të **ndalesave konkrete kushtetuese**. Përveç detyrimeve që kanë të bëjnë me qytetarët, edhe në KSerb shteti ka **detyrime konkrete kushtetuese**. Në **KSerb**, megjithatë, për dallim nga KKos, nuk ekziston një dispozitë shprehimore që sanksionon një **detyrim të përgjithshëm** të shtetit për të mbrojtur dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore (neni 21.3 i KKos). Kushtetutëbërsi serb ka zgjedhur një qasje tjetër: në nenin 23, që gjendet në pjesën e dispozitave themelore të pjesës së dytë të **KSerb**, bazat e realizimit të lirive dhe të drejtave kushtetuese duhet të kërkohet në mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe zhvillimin e lirë të personalitetit. Në fjalinë e fundit të paragrafit të dytë të nenit 23 të KSerb, vihet si detyrim moscenimi i të drejtave të tjerëve.

Liritë dhe të drejtat e njeriut realizohen jo vetëm në bazë të Kushtetutës dhe marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, si në KMZi, por edhe në bazë të parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare dhe ligjeve (neni 18.2). Me ligj mund të përcaktohet mënyra e realizimit të lirive dhe të drejtave kushtetuese, por vetëm nëse për këtë ekziston një autorizim kushtetues shprehimor apo nëse një gjë e tillë është e do-

mosdoshme për realizimin e të drejtës konkrete për shkak të natyrës së saj. Në këto raste, megjithatë, ligji asnjëherë nuk guxon të ndikojë në thelbin e të drejtës së garantuar (neni 18.3). Ky stipulim kushtetues serb është detyrimi më i përgjithshëm që ka Shteti serb ndaj realizimit të lirive dhe të drejtave kushtetuese.

Sa i përket **detyrime konkrete kushtetuese** që i vihen në barrë shtetit, ndërkaq, edhe në Serbi ato janë të theksuara pranë çdo të drejte, në veçanti në sferën e lirive dhe të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore: edhe këtu shteti ka detyrim që të ofrojë mbrojtje sociale dhe shëndetësore, mbrojtje në rast të papunësisë, ka detyrim që të mundësojë dhe organizojë fitimin (marrjen) e arsimimit adekuat, të nxisë qytetarët për tolerancë dhe të kujdeset për zhvillim. Në **KSerb** është edhe më shprehimor se në KMVer dhe KMZi detyrimi i shtetit për promovim dhe nxitje të natalitetit: Shteti nxitë prindërit për të vendosur për lindjen e fëmijëve dhe i ndihmon në këtë, thuhet në nenin 63 parag. 2 të **KSerb.**

7.5. Të drejtat e të huajve në Kosovë

Të drejtat e të huajve në **KKos** nuk janë të sistematizuara në një vend, siç ndodhë në disa kushtetuta të vendeve të huaja. Përveç kësaj, në **KKos** nuk ekziston asnjë dispozitë që definon pozitën kushtetuese të të huajve, siç e bëjnë disa prej kushtetutave të vendeve fqinje me Kosovën, që përcaktojnë se të huajt, në parim, kanë të gjitha të drejtat e garantuara me kushtetutë e ligje përveç atyre që janë të rezervuara shprehimisht për shtetasit e vendit. Të drejtat dhe liritë që rezervohen vetëm për shtetasit e vendit, zakonisht janë liritë dhe të drejtat politike.

Për arsyet si më sipër, në Kosovë, lidhur me statusin kushtetues të të huajve mund të konkludohet nga dispozitat tjera kushtetuese. Ato dispozita gjenden në nenet për sa vijon: neni 35 parag. 1 dhe 5 (liria e lëvizjes), neni 119 parag. 2 dhe 6 (marrëdhëniet ekonomike: parimet e përgjithshme), neni 121 parag. 2 dhe 3 (marrëdhëniet ekonomike: prona) dhe neni 156 që ka të bëjë me refugjatët dhe personat e zhvendosur brenda vendit.

Një e drejtë shumë emblematike e të huajve është e **drejta për strehim** (azili), e cila në Kosovë nuk figuron si garancion kushtetues. Kjo çështje normohet me ligj, siç u diskutua më sipër, por kjo nuk ndryshon faktin që nuk përfaqëson garancion kushtetues. Ajo që përfaqëson garancion kushtetues dhe që tërthorazi përfaqëson një komponentë të rëndësishme të së drejtës për strehim, gjendet në dispozitën e paragrafit të dytë të nenit 35, në kontekstin e lirisë së lëvizjes. Kjo dispozitë ua njeh të huajve të drejtën për të hyrë në Republikën e Kosovës dhe për të zënë vend (për t'u vendosur) në të. Pozita kushtetuese, sikundër shihet, për herë të parë haset në këtë nen, që normon lirinë e lëvizjes: të huajt që janë banorë të ligjshëm të Kosovës, kanë të drejtë të lëvizin lirisht në Republikën e Kosovës dhe të zgjedhin vendbanimin, pra barazohen me shtetasit kosovarë (neni 35.1).

Dispozitat tjera kushtetuese që flasin për të huajt gjenden jashtë kapitullit të dytë që normon liritë dhe të drejtat e njeriut, në Kapitullin IX ("Marrëdhëniet Ekonomike") dhe Kapitullin XIV ("Dispozitat Kalimtare").

Në paragrafin e dytë të nenit 119 ("Parimet e Përgjithshme") të Kushtetutës përcaktohet se Republika e Kosovës siguron të drejta ligjore të barabarta për të gjithë investitorët dhe të gjitha ndërmarrjet vendore dhe të jashtme, kurse në të gjashtin investitorit të jashtëm i garantohet nxjerrja e lirshme e fitimit dhe kapitalit të investuar jashtë vendit, në pajtim me ligjin.

Në dispozitat konkrete kushtetuese që normojnë marrëdhëniet ekonomike, neni 121 në dy paragrafë specifikon garancionet kushtetuese që kanë të bëjnë respektivisht **me të drejtën e pronësisë mbi patundshmëritë** dhe **me koncesionet e huaja.** Personat fizikë të huaj dhe organizatat e huaja **mund të sigurojnë të drejta të pronësisë mbi pronën e paluajtshme** në pajtim me kushtet e arsyeshme të përcaktuara me ligj ose me marrëveshje ndërkombëtare, thuhet në paragrafin e dytë.

Në paragrafin e tretë, ndërkaq, përcaktohet se personat fizikë të huaj dhe organizatat e huaja në pajtim me kushtet e arsyeshme të përcaktuara me ligj, **mund të sigurojnë të drejta të koncesionit** dhe të drejta të tjera për shfrytëzim dhe/ose eksploatim të resurseve në pronësi publike, përfshirë këtu resurset natyrore, dhe të infrastrukturës në pronësi publike.

Së fundi, dikur pjesë e Kapitullit IV, neni 156 ("Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur Brenda Vendit"), me amendamentin 17 është bartur në kapitullin II të Kushtetutës.[46] Nuk thuhet, megjithatë, se në cilin nen dhe vend në kapitullin II të Kushtetutës është vendosur kjo dispozitë kushtetuese (sic!). **Republika e Kosovës** promovon dhe lehtëson kthimin e sigurt dhe me dinjitet të refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit, dhe u ndihmon atyre për kthimin e pronave dhe posedimeve të tyre, thotë dispozita e këtij neni. Kjo dispozitë kushtetuese në kuptimin e ngushtë të fjalës nuk i takon kategorisë së të huajve, por refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda Kosovës, si pasojë e luftës së fundit në Kosovës. Futja e saj në Kushtetutë ka pasur për qëllim sanimin e pasojave të luftës së fundit në Kosovë, përmes krijimit të bazës kushtetuese për një gjë të tillë, pra duke e shndërruar në një detyrim kushtetues për Shtetin e Kosovës dhe në një të drejtë për refugjatët dhe personat e zhvendosur me origjinë nga Kosova. U mor vesh, kjo e drejtë i takon edhe refugjatëve të tjerë që nuk kanë origjinë nga Kosova, pra që janë refugjatë në territorin e Kosovës, jo në një shtet të tretë.

7.5.1. Të drejtat e të huajve në Shqipëri

Edhe në **KShq**, të drejtat e të huajve nuk janë të sistematizuara në një vend. Për dallim nga KKos, në rastin e KShq ekziston një dispozitë e përgjithshme që definon pozitën kushtetuese të të huajve: "Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëlloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara" (neni 16.1 i KShq). Siç u tha më sipër, të drejtat dhe liritë që rezervohen vetëm për shtetasit e vendit, zakonisht janë liritë dhe të drejtat politike.

Dispozitat tjera kushtetuese lidhur me rolin dhe pozitën e të huajve në Shqipëri, mund të gjenden në dispozitat e neneve si vijon: 27. 2 ("dh"), 39.3 dhe 40. Sikundër shihet, në numër janë shumë më pak dispozita për të huajt se sa në KKos.

Për dallim nga rasti kosovar, në **KShq**, e drejta shumë emblematike e të huajve, e **drejta për strehim** (azili), garantohet në mënyrë shprehimore: në nenin 40, në një dispozitë të vetme, në seksionin e lirive dhe të drejtave vetjake, përcaktohet se "Të huajt kanë të drejtën e strehimit në Republikën e Shqipërisë sipas ligjit".

Sa i përket lirisë së lëvizjes së të huajve, kushtetutëbërësi shqiptar ka zgjedhur një formulim pak më ndryshe se në rastin kosovar. Në nenin 27.2 ("dh") të **KShq.**, në seksionin për liritë dhe të drejtat vetjake, që normon lirinë e lëvizjes, thuhet se ajo mund të kufizohet "për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose të ekstradimit". Në ndërkohë që dëbimi nuk ka të bëjë me shtetasit shqiptar, por vetëm me të huajt dhe personat pa shtetësi, atëherë qartë shihet se lëvizja e lirë e të huajve është e garantuar, përveç rasteve kur me ligj përcaktohen kufizimet e saj. Ky garancion kushtetues përforcohet edhe më shumë me dispozitën e nenit 39.3 që përcakton si vijon: "Ndalohet dëbimi kolektiv i të huajve. Dëbimi i individëve të huaj lejohet në kushtet e përcaktuara me ligj".

[46] Amendamentet I – XXII. **Amendamentimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare te pavarësisë së Kosovës** (*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës* nr. 25 datë 7 shtator 2012.

Jashtë këtyre dispozitave kushtetuese, nuk gjendet ndonjë dispozitë tjetër që normon statusin apo liritë dhe të drejtat e të huajve dhe personave pa shtetësi. Kjo nënkupton se, si në vendet tjera, pjesa dërrmuese e kësaj materie i lihet për normim ligjvënësit të zakonshëm.

7.5.2. Të drejtat e të huajve në Maqedoninë e Veriut

Liritë dhe të drejtat e të huajve dhe personave pa shtetësi në KMVer nuk janë të sistematizuara në një vend. Për dallim nga rasti i KKos, në KMVer ekziston një dispozitë, ngjashëm si në KShq., që definon pozitën kushtetuese të të huajve dhe personave pa shtetësi. E kemi fjalën për dispozitën e nenit 29.1, që përcakton si vijon: "Të huajt në Republikën e Maqedonisë së Veriut i gëzojnë liritë dhe të drejtat e garantuara me Kushtetutë, me kushte të përcaktuara me ligj dhe me marrëveshje ndërkombëtare". Sikundër shihet, redaktimi i këtij garancioni kushtetues është më i fuqishëm se në rastin e KShq., sepse si bazë juridike i njeh edhe marrëveshjet ndërkombëtare. Në rast të konfliktit të stipulimit ligjor për të huajt dhe personat pa shtetësi, vlejnë dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare, për faktin se KMVer njeh epërsinë e tyre kundrejt çdo norme ligjore. Këto liri dhe të drejta të të huajve dhe personave pa shtetësi që garanton KMVer nuk përfshijnë liritë dhe të drejtat e rezervuara për shtetasit e vendit, të cilat, edhe në Maqedoninë e Veriut, zakonisht janë liritë dhe të drejtat politike.

Dy paragrafët tjera të nenit 29 të KMVer, i cili është neni i fundit në seksionin e lirive dhe të drejtave civile dhe politike, normojnë dy të drejta shumë jetike për të huajt dhe personat pa shtetësi: në nenin 29.2 normohet e **drejta për strehim** (azili) e të huajve dhe personave pa shtetësi, të përndjekur për shkak të bindjeve dhe veprimeve politike demokratike, kurse në nenin 29.3 rregullohet ekstradimi i të huajve dhe personave pa shtetësi. Instituti i ekstradimit të të huajve dhe personave pa shtetësi në KMVer gëzon një status të qartë, gjykuar sipas formulimit të dispozitës së paragrafit të tretë të nenit 29. Në fillim, në fjalinë e parë, thuhet se "Ekstradimi i të huajit mund të bëhet vetëm në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar dhe në bazë të parimit të reciprocitetit", kurse në të dytën shprehimisht përcaktohet se "I huaji nuk mund të ekstradohet për shkak të veprës penale politike", kurse "Veprimet e terrorizmit nuk konsiderohen vepra penale politike". Me këto tri garancione kushtetuese, Maqedonia e Veriut iu ka dhënë garancione kushtetuese shumë më të qarta se **KKos** dhe **KShq**.

Në seksionin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, **KMVer** ka dy nene të rëndësishme që u ofrojnë mundësi të huajve për të ndërtuar jetë ekonomike në kushte të barabarta: në nenin 31 thuhet se "Personi i huaj në Republikën e Maqedonisë mund të fitojë të drejtën e pronësisë, në kushtet e përcaktuara me ligj", kurse në nenin 59 garantohen investimet e huaja dhe të drejtat që dalin nga to. Në paragrafin e parë të këtij neni: "Investitorëve të huaj u garantohet e drejta e nxjerrjes së lirë të kapitalit të investuar dhe të fitimit", kurse në të dytin, të huajve u garantohet se "Të drejtat e fituara në bazë të kapitalit të investuar, nuk mund të zvogëlohen me ligj ose me rregull tjetër".

7.5.3. Të drejtat e të huajve në Mal të Zi

Edhe në **KMZi**, të drejtat e të huajve nuk janë të sistematizuara në një vend dhe nuk ekziston asnjë dispozitë që definon pozitën e tyre kushtetuese, siç ishte rasti me **KShq** dhe **KMVer**. Neni 19 i **KMZi**, megjithatë, garanton barazinë e çdokujt në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave njerëzore dhe nuk bën dallim në mes të shtetasve dhe të huajve dhe personave pa shtetësi. Kjo është kështu sepse dispozita e nenit në fjalë gjendet në pjesën e përgjithshme të pjesës së dytë të **KMZi** që normon liritë dhe të drejtat kushtetuese.

Dispozitat për ta huajt dhe personat pa shtetësi, në krahasim me vendet tjera përreth, në **KMZi** janë më të pakta në numër dhe gjendet në nenet e saj 39.3, 44 dhe 61.

Në nenin 39.3 të KMZi, që gjendet në kuadër të seksonit të dytë ("Liritë dhe të drejtat vetjake") dhe normon lirinë e lëvizjes, garanton lirinë e lëvizjes së të huajve, në pajtim me ligjin. Ky formulim është shumë i ngjashëm më stipulimet e vendeve përreth Kosovës dhe instrumentet e dokumentet tjera ndërkombëtare, në rend të parë të KEDNJ-së.

Në nenin 44 sanksionohet në mënyrë shumë të saktë **e drejta e strehimit (azili)**, si nen i fundit në kuadër të seksionit të dytë si më sipër. Paragrafi i parë ofron garancionin e strehimit për çdokënd që përndjekjet për shkak të racës, fesë, gjuhës apo përkatësisë së ndonjë kombi ose grupi për shkak të bindjeve politike. I dyti paragraf ndalon dëbimin e të huajve në një vend ku ata mund të vriten, përndjekjen për shkaqet nga paragrafi i parë i këtij neni. Në këtë paragraf si shkak shtesë merret edhe rreziku për të huajt nga cenimi i lirive dhe të drejtave që garanton KMZi. Në paragrafin e fundit thuhet se vetëm me vendim të organit kompetent mund të kryhet dëbimi, sipas procedurës së përcaktuar ligjore.

Së fundi, në kuadër të garancioneve kushtetuese të lirive dhe të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, në nenin 61 të KMZi garantohet e drejta e pronës për shtetasit e huaj, në pajtim me ligjin. Edhe ky është një standard i përhapur me kushtetutat e vendeve të ndryshme të Evropës, si dhe me dokumente e instrumente ndërkombëtare, në rend të parë me KEDNJ.

7.5.4. Të drejtat e të huajve në Serbi

Edhe në **KSerb**, të drejtat e të huajve nuk janë të sistematizuara në një vend. Në Serbi, megjithatë, ekziston një dispozitë shprehimore që definon pozitën e tyre kushtetuese, njëjtë siç ishte rasti me KShq dhe KMVer. Në nenin 17 të parimeve themelore, **KSerb**, në një dispozitë të vetme, thekson se "Të huajt, në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare, në Republikën e Serbisë kanë të gjitha të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe ligj, përveç atyre të drejtave që Kushtetuta dhe ligji ua kanë njohur vetëm shtetasve të Republikës së Serbisë".

Neni në vijim, gjithashtu në parimet themelore kushtetuese, garanton barazinë e çdokujt në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave njerëzore dhe nuk bën dallim në mes të shtetasve serb dhe të huajve e personave pa shtetësi. Pas kësaj dispozite, një vend tjetër ku përmenden të huajt, por jo edhe personat pa shtetësi, është neni 39 që normon lirinë e lëvizjes, me një formulim shumë të ngjashëm me stipulimet e vendeve përreth Kosovës, si dhe instrumenteve e dokumenteve të tjera ndërkombëtare, në rend të parë të **KEDNJ**. Në nenin në fjalë, nenin 39, **KSerb** në gjithsej tre paragrafë normon lirinë e lëvizjes, ku paragrafi i fundit i dedikohet garantimit të lirisë së lëvizjes për të huajt. Aty përcaktohet si vijon: "Hyrja e të huajve në Republikën e Serbisë dhe qëndrimi në të rregullohen me ligj. I huaji mund të dëbohet vetëm në bazë të vendimit të organit kompetent, në procedurë të përcaktuar ligjore dhe pasi të jetë garantuar e drejta për ankesë dhe atë vetëm atje ku nuk kërcënohet nga përndjekja për shkak të racës, gjinisë, fesë, përkatësisë nacionale, shtetësisë, përkatësisë grupit të caktuar shoqëror, mendimit politik apo atje ku nuk rrezikohet në mënyrë serioze shkelja e të drejtave të saj/tij të garantuara me kushtetutë".

Në nenin 57, në dy paragrafë, KSerb garanton të **drejtën e strehimit (azili).** Paragrafi i parë ofron garancionin e strehimit për çdokënd që përndiqet për shkak të racës, gjinisë, fesë, përkatësisë nacionale apo ndonjë kombi apo për shkak të bindjeve të veta politike. I dyti paragraf përcakton se ligjvënësi duhet të normojë me ligj procedurën për fitimin e azilit në këtë vend fqinjë me Kosovën. Këtu nuk flet për ndalimin e dëbimit të të huajve në një vend ku ata mund të vriten dhe përndjekjen për shkaqet nga paragrafi i parë i këtij neni, siç e bën KMZi. Këtë kushtetutëbërësi serb e ka

normuar, sikundër u pa, në normën kushtetuese që rregullon lirinë e lëvizjes. E njëjta vlen edhe për vendimin individual të organit kompetent si kusht realizimin e dëbimit të të huajve. Krejt këto procedura, pra, normohen me ligjin serb mbi të drejtat e të huajve, siç bëjnë edhe vendet tjera të Evropës, përfshirë Kosovën.

Së fundi, në kuadër të garancioneve kushtetuese të lirive dhe të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, **KSerb** ka paraparë disa liri dhe të drejta konkrete për të huajt, që nuk hasen në vendet tjera përreth me kaq qartësi. E kemi fjalën për nenet 84 dhe 85 të pjesës së tretë mbi rregullimin ekonomik dhe financat e Serbisë. Neni 84 ka katër paragrafë. Në të parin garantohet pozita e barabartë e të gjithëve në treg. Në të dytin ndalohet konkurrenca e pandershme dhe jolojale, krijimi i pozitës monopolistike ose dominante në treg. Në të tretin shprehimisht thuhet se të drejtat e fituara me investime në bazë të ligjit, nuk mund të zvogëlohen me ligj. Në fund fare, të huajt barazohen në treg me personat e vendit. Në ndërkohë që neni 84 normon pozitën në treg të të huajve dhe të tjerëve, neni 85 flet për të drejtat pronësore të të huajve në mënyrë krejt specifike. Në paragrafin e parë garantohet e drejta e të huajve për fitimin e pronësisë mbi patundshmëritë, në pajtim me ligj ose me marrëveshje ndërkombëtare. Paragrafi i dytë garanton të drejtën për koncesione ndaj pasurive natyrore serbe dhe të mirave në interes të përgjithshëm si dhe të drejtave të tjera që rregullohen me ligj. Sikundër shihet, garancionet kushtetuese të lirisë ekonomike të të huajve janë më të forta në KSerb se në vendet përreth Kosovës.

7.6. Të drejtat e minoriteteve në Kosovë

Komunitetet etnike, gjuhësore ose fetare, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës, siç definohen minoritetet në Kosovë, gëzojnë disa të drejta dhe kanë disa detyrime që nuk i kanë të tjerët, në ndërkohë që gëzojnë të gjitha liritë dhe të drejtat njerëzore të garantuara me Kushtetutë, sikur qytetarët tjerë të Kosovës: neni 57 parag. 1 i **KKos**, në këtë kuptim, shprehimisht thotë se "Banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës (Komunitetet), gëzojnë të drejta të veçanta, të përcaktuara me këtë Kushtetutë, krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të përcaktuara në Kapitullin II të kësaj Kushtetute", kurse paragrafi 4 vënë në spikamë detyrimet kushtetuese të komuniteteve kosovare, kur thotë se "Ushtrimi i këtyre të drejtave do të bartë me vete detyrimet dhe përgjegjësitë për të vepruar në pajtim me ligjin e Republikës së Kosovës, dhe nuk i cenon të drejtat e të tjerëve".

Liritë dhe të drejtat e komuniteteve janë kategoria e vetme kushtetuese që shoqërohet me një katalog të gjerë të përgjegjësive që ka **Republika e Kosovës** karshi tyre, me qëllim që ato mos të jenë liri dhe të drejta iluzore, por efektive dhe të prekshme për secilin anëtar të komunitetit dhe vetë komunitetin si tërësi. E kemi fjalën për dispozitat e nenit 58 të KKos lidhur me **përgjegjësitë e Shtetit**, që u diskutuan ne fund të nënseksionit paraprak më sipër. Tërë këto dispozita garantojnë të drejta e liri shtesë për komunitetet e Kosovës, të definuar si më sipër në bazë të tri kritereve dalluese identitare: etnia, gjuha dhe feja, gjithnjë me kusht që të kenë qenë të pranishëm tradicionalisht në territorin e Kosovës.

Të drejtat individuale realizohen në mënyrë individuale nga secili anëtar i komunitetit (57.1), kurse të drejtat kolektive realizohen së bashku me pjesëtarët tjerë të komunitetit (neni 57.3), në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin dhe me kusht që nuk cenon të drejtat e të tjerëve (neni 57.4). Krahas Kushtetutës dhe ligjit si pikë referimi për vlerësimin e detyrimit dhe përgjegjësive kushtetuese të komuniteteve me rastin e ushtrimit dhe realizimit të lirive dhe të drejtave nga Kapitulli III është dashur të jetë edhe kategoria e **marrëveshjeve ndërkombëtare**, siç e bëjnë disa vende fqinje me **Kosovën**. Futja e marrëveshjeve ndërkombëtare si pikë referimi, në rastin e Kosovës bëhet edhe më e nevojshme nëse kihet parasysh fakti se vendi ynë ka konstitucionalizuar në nenin 22 të Kushtetutës

pjesën kryesore të së drejtës ndërkombëtare mbi liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve.

Në kuadër të **përgjegjësive të Shtetit**, sipas stipulimit të nenit 58 të Kushtetutës, vend të posaçëm zënë dispozitat që garantojnë **realizimin e barazisë së plotë** dhe **ruajtjen e identitetit të komuniteteve**. Me qëllim të ruajtjes së identitetit, fjalia e parë e paragrafit të parë të nenit 58 garanton se shteti siguron kushtet e duhura, të cilat u mundësojnë komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre që të ruajnë, të mbrojnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre, kurse paragrafi i katërt i nenit të njëjtë i vë detyrë shtetit miratimin e masave adekuate për të promovuar barazi të plotë dhe efektive të pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore dhe pjesëmarrjen efektive të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në jetën publike dhe në vendimmarrje, masa që nuk konsiderohet se janë vepër e **diskriminimit**.

Pas normimit të përgjegjësisë së përgjithshme të shtetit karshi komuniteteve, neni 59 i Kushtetutës, në mënyrë specifike normon katërmbëdhjetë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, të cilët kanë të drejtë që, në mënyrë individuale ose si komunitet:

- të shprehin, mbajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre dhe të ruajnë elementet thelbësore të identitetit të tyre, përkatësisht fenë, gjuhën, traditat dhe kulturën e tyre;
- të marrin arsimim publik në të gjitha nivelet, në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, sipas zgjidhjes së tyre;
- të marrin arsimim publik parafillor, fillor dhe të mesëm, në gjuhën e tyre, deri në masën e përcaktuar me ligj, ku pragu për themelimin e paraleleve a shkollave të veçanta për këtë qëllim, do të jetë më i ulët sesa ai që përcaktohet rëndom për institucionet arsimore;
- të themelojnë dhe të menaxhojnë institucionet private të arsimit dhe trajnimit, për të cilat mund të jepet ndihma financiare publike, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare;
- të përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre lirisht në jetën private dhe publike;
- të përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre në marrëdhëniet e tyre me autoritetet komunale ose me zyrat lokale të autoriteteve qendrore në fushat në të cilat ata përfaqësojnë një pjesë të mjaftueshme të popullatës, në pajtim me ligjin. Shpenzimet e bëra për interpretuesit ose përkthyesit, do të mbulohen nga autoritetet kompetente;
- të përdorin dhe të shfaqin simbolet e komunitetit, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare;
- të regjistrojnë emrat personalë në formën e tyre origjinale dhe në shkrimin e gjuhës së tyre, si dhe emrat e tyre t'i kthejnë në formën origjinale, nëse u janë ndryshuar me dhunë;
- të kenë emërtime lokale, emërtime të rrugëve dhe tregues të tjerë topografikë, që pasqyrojnë dhe janë të ndjeshëm ndaj karakterit shumetnik dhe shumëgjuhësor të zonës përkatëse;
- të kenë qasje të garantuar dhe përfaqësim të veçantë në mediet transmetuese publike si dhe programet në gjuhën e tyre, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare;
- të krijojnë dhe të përdorin mediet e tyre vetjake, përfshirë këtu ofrimin e informacioneve në gjuhën e tyre, ndër të tjera, përmes gazetave ditore e shërbimeve kabllore, dhe përdorimin e një numri të rezervuar të frekuencave për mediet elektronike, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare. Republika e Kosovës do të marrë të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e një plani ndërkombëtar të frekuencave, për t'i mundësuar komunitetit serb në Kosovë qasje në një kanal televiziv të pavarur, të licencuar në gjuhën serbe, në mbarë Republikën e Kosovës;
- të gëzojnë kontakte të papenguara ndërmjet tyre përbrenda Republikës së Kosovës, dhe të themelojnë e të mbajnë kontakte të lira dhe paqësore me personat në cilindo shtet, sidomos me ata që kanë të përbashkët identitetin etnik, kulturor, gjuhësor a fetar, ose trashëgiminë e përbashkët kulturore, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare;
- të gëzojnë kontakte të papenguara dhe të marrin pjesë, pa diskriminim, në aktivitetet e organizatave joqeveritare lokale, rajonale dhe ndërkombëtare;

- të themelojnë shoqata të kulturës, artit, shkencës dhe arsimit, si dhe shoqata të studiuesve e shoqata të tjera për shprehjen, avancimin dhe zhvillimin e identitetit të tyre.

Niveli i parë i mbrojtjes jojuridike i komuniteteve është përmes **Këshillit Konsultativ për Komunitete** që parashihet në nenin 60 të Kushtetutës. Ai vepron nën autoritetin e Presidentit të Republikës së Kosovës, në të cilin përfaqësohen të gjitha komunitetet (neni 60.1). Ky organ përbëhet, përveç të tjerësh, nga përfaqësues të asociacioneve të komuniteteve (neni 60.2.) dhe ka këtë mandat (neni 60.3):

- ofrimin e një mekanizmi për shkëmbimin e rregullt ndërmjet komuniteteve dhe Qeverisë së Kosovës;
- mundësinë e komuniteteve për të komentuar në një fazë të hershme nismat legjislative dhe politike, të cilat mund të përgatiten nga Qeveria, për të sugjeruar nisma të tilla dhe për të kërkuar që pikëpamjet e tyre të përfshihen në projektet dhe programet përkatëse; dhe,
- çdo përgjegjësi a funksion tjetër, në pajtim me ligjin.

Sikundër shihet, kjo mbrojtje është mbrojtje jojuridike dhe, për pasojë, jo edhe aq efektive kur bëhet fjalë për liritë dhe të drejtat e komuniteteve. Këtu bëhet fjalë kryesisht për mbrojtje politike, që nuk prodhon pasoja juridike në kuptim të ndalimit ose pengimit të veprimeve eventuale arbitrare kundër lirive dhe të drejtave të komuniteteve. Një mbrojtje e tillë ofrohet më vonë, me nenin 62 të **KKos**, që rregullon çështjen e përfaqësimit të komuniteteve, përfshirë këtu përfaqësimin e tyre në procedura pranë **Gjykatës Kushtetuese** me qëllim të mbrojtjes së parimit themelor – parimit të barazisë së të gjithë qytetarëve para Kushtetutës dhe ligjit. Mbrojtja tjetër ligjore që kryhet pranë organeve administrative dhe gjyqësorit të rregullt është e njëjtë si për çdo qytetar dhe nuk ka specifikë që vlen këtu të veçohet. Ajo që dallon dhe ka rëndësi për të drejtën kushtetuese është mbrojtja pranë **Gjykatës Kushtetuese**, që diskutohet në vijim.

Në nenin 61 të KKos, që normon **çështjen e përfaqësimit të komuniteteve në punësim në institucionet publike**, bëhet ndarja në mënyrë të posaçme e kësaj të drejte të komuniteteve, me qëllim të sigurimit të barazisë në punësim në organet publike dhe ndërmarrjet publike në të gjitha nivelet, përfshirë këtu veçanërisht në shërbimin policor në zonat e banuara me komunitetin përkatës. Sipas kësaj dispozite, realizimi i kësaj të drejte nga ana e pjesëtarëve të komunitetit përkatës nuk mund të bëhet duke shkelur rregullat që kanë të bëjnë me kompetencën dhe integritetin e qeverisjes së administratës publike. Ajo që bije në sy është specifikimi i punësimit në shërbimin policor, si njëri ndër shërbimet shtetërore që posedojnë me forcën represive dhe, për pasojë, me mundësinë potenciale për diskriminim ndaj komuniteteve dhe abuzim me pushtetin policor në përgjithësi. Kjo dispozitë, nuk do mend, figuron aty marrë parasysh historinë e hidhur me terrorin policor që Kosova ka pësuar gjatë të kaluarës historike, në veçanti gjatë kohës së pushtimit serb të diktatorit serb **Sllobodan Millosheviq** (*Slobodan* Milošević: 1941-2006) përgjatë viteve 1986-1999.

Edhe neni në vijim, neni 62 i KKos, i kushtohet përfaqësimit, por tani përfaqësimi ka të bëjë me organet e pushtetit lokal. Përveç përfaqësimit dhe përgjegjësive të autoriteteve publike në nivel lokal, ky nen rregullon edhe mbrojtjen kushtetuese të lirive dhe të drejtave të komuniteteve, kur ato nëpërkëmben nga ana e komunitetit shumicë. Kjo mbrojtje, krahas mbrojtjes administrative, që kryhet në resorët përkatës ministerial në kuadër të mbikëqyrjes administrative të ligjshmërisë së punës të organeve të pushtetit lokal, dhe mbrojtjes gjyqësore që kryhet pranë gjykatave të rregullta që vlerësojnë ligjshmërinë e vendimeve të organeve administrative, realizohet edhe në Gjykatën Kushtetuese. Ky nen, me fjalë të tjera, normon vetëm mbrojtjen juridiko-kushtetuese të lirive dhe të drejtave të komuniteteve pranë **Gjykatës Kushtetuese**.

Sa i përket përfaqësimit, në paragrafin e parë të nenit 62 Kushtetuta përcakton se në komunat në të cilat së paku 10% e banorëve u përkasin komuniteteve, të cilat në ato komuna nuk janë shumicë, posti i **zëvendëskryetarit për komunitete** të kuvendit të komunës do të rezervohet për një përfaqësues nga radhët e këtyre komuniteteve. Këtë post e mban kandidati që i përket popullatës që nuk është shumicë, që ka marrë shumicën e votave në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje për kuvendin e komunës (neni 62 parag. 2). Detyra themelore e **zëvendëskryetarit për komunitete** është promovimi i dialogut ndërmjet komuniteteve dhe të shërbejë si pikë formale e kontaktit për adresimin e brengave dhe interesave të komuniteteve që nuk janë shumicë në takimet e kuvendit të komunës dhe në punët e saj. **Zëvendëskryetari** gjithashtu është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave që parashtrohen nga komunitetet ose pjesëtarët e tyre, nëse aktet a vendimet e kuvendit të komunës shkelin të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë. Zëvendëskryetari këto çështje ia referon kuvendit të komunës, për rishqyrtimin e aktit a të vendimit të marrë (neni 62.3). Në rast se kuvendi i komunës vendos që të mos rishqyrtojë aktin a vendimin e vet, ose nëse zëvendëskryetari vlerëson se, edhe pas rishqyrtimit rezultati përbën shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, ai/ajo mund të parashtrojë çështjen drejtpërdrejt në **Gjykatën Kushtetuese**, e cila mund të vendosë nëse do të pranojë ta shqyrtojë rastin përkatës (neni 62.2). Rasti i parë dhe më i rëndësishëm në praktikën e **Gjykatës Kushtetuese** lidhur me këtë është rasti i njohur si rasti **Logos së Prizrenit**.[47] Aktgjykimi për këtë rast, i dhënë në ditët e para të punës së Gjykatës Kushtetuese, është ndër aktgjykimet më elokuente dhe më të qarta, që ka kontribuar jashtëzakonisht shumë në vënien e themeleve të sundimit të ligjit në Kosovë. Çështje për vendosje në këtë rast ishte pozita e komunitetit joshumicë në qytetin e vjetër të **Prizrenit**.[48] Më 22 prill 2009, **Cemajl Kurtishi**, Zëvendëskryesues i Komunës së Prizrenit parashtroi kërkesë në Gjykatë duke pretenduar se neni 7 i Statutit të Komunës së Prizrenit ishte në kundërshtim me nenet 3.1[49]; 6.1[50]; dhe 59.1[51] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Përveç argumenteve materiale duke theksuar se emblema e komunës duhet të simbolizojë dhe përçojë porosinë e bashkëjetesës e komuniteteve dhe pjesëtarëve të komuniteteve dhe ekzistimin e ambienteve multietnike, multikulturale, multireligjioze dhe shumëgjuhësore[52], **Cemajl Kurtisi** po ashtu ngriti argumente tjera të natyrës procedurale duke këmbëngulur se emblema nuk ishte miratuar me shumicën e dy të tretave (2/3) të Kuvendit siç kërkohet me nenin 7.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.[53] Kuvendi Komunal i mohoi këto pretendime[54].

Pas një ekzaminimi dhe vlerësimi të gjatë, shumë të hollësishëm dhe të kujdesshëm të fakteve të rastit si dhe argumenteve të të dy palëve[55], Gjykata gjeti se Kuvendi Komunal kur mori vendim për të miratuar nenin 7 të Statutit, kishte imponuar një emblemë që nuk mund të konsiderohej simbol i përbashkët i të gjithë njerëzve që jetojnë në Prizren, dhe kishte mbipërfaqësuar identitetin e komunitetit etnik shqiptar në raport me identitetin e komuniteteve tjera në Prizren[56]. Duke vepruar kështu Ku-

47 Aktgjykimi në rastin nr. **KO 01/09**. *Cemajl Kurtishi kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit*, i 18 marsit 2010.

48 Prizreni është qytet në jug të Kosovës ku filluan aktivitetet politike dhe ushtarake të shqiptarëve kundër sundimit otoman që kulmuan në një lëvizje shumë të konsoliduar të rezistencës kombëtare. Këtë fakt e njeh edhe Gjykata në paragrafin 43 ku, *inter alia,* thuhet se "…Kjo Gjykate është e vetëdijshme që shqiptaret identifikohen me "1878"-shin e shkruar ne emblemën e Komunës së Prizrenit, ashtu siç thuhet me nenin 7 të Statutit të Komunës. Viti 1878 ka qenë viti i themelimit të Lidhjes së Prizrenit. Udhëheqësit shqiptarë u mblodhën në Prizren, më 10 qershor të atij viti, duke kërkuar të arrijnë shtetin e pavarur shqiptar".

49 Neni 3.1 [Barazia para Ligjit]: "Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore".

50 Neni 6.1 [Simbolet]: "Flamuri, stema dhe himni janë simbolet shtetërore të Republikës së Kosovës të cilat pasqyrojnë karakterin shumetnik të saj".

51 Neni 59.1 [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre]: "Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë që, në mënyrë individuale ose si komunitet: 1. të shprehin, mbajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre dhe të ruajnë elementet thelbësore të identitetit të tyre, përkatësisht fenë, gjuhën, traditat dhe kulturën e tyre".

52 Paragrafi 12 i aktgjykimit.

53 Paragrafi 13 i aktgjykimit.

54 Për argumentet e Kuvendit Komunal, cf. paragrafët 20-25 të akgjykimit.

55 Cf. Paragrafët 26-54.

56 Cf. Paragrafi 55 i aktgjykimit.

vendi Komunal kishte shkelur Kushtetutën e Republikës së Kosovës, më konkretisht nenet 3; 7.1; 58 dhe 59.[57] Sipas Gjykatës, kjo do të thotë se Kuvendi Komunal nuk kishte konsideratë apo nuk kishte konsideratën e duhur për të drejtat dhe liritë themelore që ua jep Kushtetuta komuniteteve joshumicë për të ruajtur, mbajtur dhe promovuar identitetet e tyre. Për këtë arsye, Gjykata në pikën IV të pjesës operative urdhëroi"…Komunën e Prizrenit që, brenda një periudhe prej tre muajsh nga dorëzimi i këtij Aktgjykimi, të ndryshojë Statutin dhe emblemën e saj në mënyrë që ta sjellë atë në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe të mos përjashtojë komunitetet joshumicë". Kjo në fakt edhe ndodhi më vonë: Komuna e Prizrenit e ndryshoi nenin 7 të Statutit të saj ashtu që emblema e tanishme e qytetit është plotësisht në pajtim me Kushtetutën.[58]
Në pjesën e fusnotave të këtij aktgjykimi vlen të përmendet mendimi konkurrues i gjyqtarit **Almiro Rodrigues**, jo pse ai shton ndonjë vlerë të vërtetë pikëpamjeve të shumicës siç janë shprehur në aktgjykim, por për shkak të natyrës tejet kontradiktore. Duke qenë vetë gjyqtar raportues, **Almiro Rodrigues** paralajmëroi se do të jepte mendim konkurrues në ditën kur Gjykata po merrte vendim. Në fakt, posa e paraqiti atë, ai doli të ishte një diskutim i fokusuar kryesisht në pjesën operative të aktgjykimit dhe pikërisht në faktet dhe meritat e vetë rastit.[59]

Një segment shumë i rëndësishëm i përfaqësimit është edhe përfaqësimi në nivel lokal në organin ekzekutiv. Përfaqësimi në **organin ekzekutiv për komunitetet** që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës është i garantuar (neni 62.5). Kjo nënkupton që këtu nuk bëhet fjalë për përqindje të popullsisë, si kriter apo parametër matës për përfaqësim, por për përfaqësim të garantuar me Kushtetutë që diktohet nga natyra e organit, bëhet fjalë për organin ekzekutiv.

Sikundër mund të shihet nga sa më sipër, ekzistojnë një mori lirish dhe të drejtash që kanë komunitetet në Kosovë, që janë liri dhe të drejta shtesë ndaj atyre të kapitullit të dytë të Kushtetutës. Për nga natyra e tyre, ato janë kryesisht relative dhe mund të privohen dhe kufizohen në kushtet të njëjta sikur edhe liritë dhe të drejtat e njeriut nga kapitulli i dytë. Kjo nënkupton, gjithashtu, se ekzistojnë edhe disa liri dhe të drejta që janë absolute dhe që duhet të jenë posaçërisht në fokus të punës së autoriteteve publike në Kosovë: ato janë **ndalimi i diskriminimit** dhe **ndalimi i asimilimit të dhunshëm**. Kushtetuta nuk e thotë, por nënkuptohet se, në kuadër të politikave të asimilimit hyn edhe asimilimi i dhunshëm përmes ndryshimit të strukturës etnike, gjuhësore dhe fetare të popullsisë me qëllim që numri të zvogëlohet aq sa të tjerët të asimilohen më pastaj me metoda administrative. Kjo praktikë ka qenë shumë prezente në territorin ish-jugosllav ndaj pakicës shqiptare dhe pakicave të tjera.

7.6.1 Të drejtat e minoriteteve në Shqipëri

Edhe në Shqipëri, bazat për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të pakicave gjenden në dispozitat e **KShq** që në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me mbrojtjen, si dhe në dispozitat mbi kompetencat e organeve shtetërore. **KShq** rregullon dhe siguron mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, si dhe përgjegjësinë dhe sanksionet për shkeljen apo cenimin e tyre. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik (neni 15 parag. 1). Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre (neni 15 parag. 2). Të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara ne Kushtetutë vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve (neni 16 parag. 2). Në nivel të qeverisjes lokale, për dallim nga Kosova, **KShq**

[57] Cf. Pjesa operative, pika III e aktgjykimit.
[58] Më 18 qershor 2010, Kryetari i Prizrenit, dr. Ramadan Muja, i dërgoi një letër Gjykatës në të cilën kërkoi zgjatjen e afatit prej 3 muajsh të caktuar në aktgjykimin KI No. 01/09 edhe për gjashtëdhjetë (60) ditë tjera. Me Urdhrin e saj të 21 qershorit 2010, Gjykata vendosi të lejonte këtë zgjatje të afatit. Komuna e Prizrenit përfundimisht veproi në përputhje me aktgjykimin e Gjykatës më 24 mars 2011 kur miratoi Vendimin Nr. 01/011-3581 për Ndryshimin e Statutit të Komunës së Prizrenit.
[59] Cf. Mendimi konkurrues i gjyqtarit **Almiro Rodrigues** për aktgjykimin në rastin nr. 01/09, konkretisht në lidhje paragrafin 14.

nuk i kushton një kujdes pakicave kombëtare dhe as nuk normohen parimet e punës së qeverisjes vendore, që përbëjnë standard ndërkombëtar të **KEVL-së**, siç janë: vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre. Në vend të kësaj, **KShq**, kur flet për ndarjet administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore, thekson se ato ”caktohen me ligj mbi bazën e nevojave e të interesave të përbashkët ekonomikë dhe të traditës historike”. (neni 108 parag. 2).

Sa i përket mekanizmit të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të pakicave, edhe KShq njeh mbrojtjen gjyqësore, mbrojtjen pranë Gjykatës Kushtetuese dhe mbrojtjen nga Avokati i Popullit.
Mbrojtja fillestare është pranë gjykatave: “Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor”. (neni 42 parag. 1). Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj (neni 42 parag. 2). Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës (neni 43). **KShq** nuk përmban dispozita shprehimore që kanë formë garancioni kushtetuese për qytetarët e vendit, për të shfrytëzuar mekanizmat juridik dhe gjyqësor ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të tyre (**GJEDNJ-ja** dhe **Komiteti i OKB**-së). Mirëpo, marrë parasysh faktin se Shqipëria është anëtare e **KE-së** dhe e **OKB-së** dhe, për pasojë, i **KEDNJ-së** dhe **PDCP-së**, atëherë nënkuptohet se ekziston e drejta e qytetarëve dhe subjekteve të tjerë të së drejtës shqiptare për t’iu drejtuar këtyre institucioneve ndërkombëtare dhe forumeve të tjera ku Shqipëria është anëtar si shtet sovran dhe i pavarur në kuptim e plotë të këtij koncepti.

Mbrojtja e drejtpërdrejtë e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve realizohet edhe pranë **Gjykatës Kushtetuese,** e cila vendos për “gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë” (neni 131 parag. 1 pika”f”).

Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike (neni 60 parag.1). Mbrojtja që ofron ky organ, megjithatë, njëjtë si në Kosovë, nuk është juridike sepse vendimet e marra në vijim të mbrojtjes së të drejtave, lirive dhe interesave individuale nuk kanë fuqi ekzekutive (nuk mund të ekzekutohen me dhunë).

Sikundër shihet, konceptualisht, nuk ka asnjë dallim në mes të zgjidhjeve kushtetuese shqiptare dhe atyre të Kosovës, sa i përket mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut. I vetmi dallim është se, nga Kosova, **KShq** bën kategorizimin e lirive dhe të drejtave sipas gjeneratave dhe e bënë më të lehtë shfrytëzimin dhe interpretimin e tyre.

7.6.2. Të drejtat e minoriteteve në Maqedoninë e Veriut

Të drejtat e minoriteteve në **KMVer** kanë një vend të posaçëm dhe gjenden si në preambulë ashtu edhe në pjesën operative, në të cilën gjenden institucione që përkujdesen për zhvillimin e bashkëjetesës së popullit sllavo-maqedonas me popullsitë tjera që jetojnë në Maqedoninë e Veriut.

Preambula e **KMVer** zë një vend të posaçëm sa i përket promovimit të barazisë së popujve që jetojnë në këtë vend fqinjë me Kosovën. Me **KMVer** të vitit 1991, ka qenë e sforcuar ideja e **Maqedonisë së Veriut** si shtet i kombit maqedon. Aty përmendej, *inter alia*, “fakti historik se Maqedonia është konstituuar

si shtet nacional i popullit maqedonas në të cilin sigurohet barazia e plotë qytetare dhe bashkëjetesa e përhershme e popullit maqedonas me shqiptarët, turqit, vllahët, romët dhe kombësitë e tjera që jetojnë në Republikën e Maqedonisë". Me amendamentin IV të datës 16 nëntor 2001, Preambula është ndryshuar në tërësi. Tani ajo fillon më një qasje tjetër, në të cilin konstatohet, *inter alia*, se "Qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut, populli maqedonas, si dhe qytetarët të cilët jetojnë brenda kufijve të saj të cilët janë pjesë e popullit shqiptar, popullit turk, popullit vlleh, popullit serb, popullit rom, popullit boshnjak, e të tjerë, duke e marrë përsipër përgjegjësinë për të tashmen dhe të ardhmen e atdheut të tyre, të vetëdijshëm dhe mirënjohës ndaj paraardhësve të tyre për viktimat dhe përkushtimin e përpjekjeve të tyre dhe luftës për krijimin e shtetit të pavarur dhe sovran të Maqedonisë".

Në dispozitat operative të **KMVer** gjendet rregullimi i statusit dhe kompetencave të Këshillit për marrëdhënie ndëretnike. Ky trup përbëhet nga përfaqësues të popullit sllavo-maqedonas dhe përfaqësues të nacionaliteteve të Maqedonisë së Veriut, në baza të paritetit (neni 78, siç është amendamentuar me amendamentin VIII të datës 16 nëntor 2001).

Me **KMVer** garantohet liritë dhe të drejtat e pjesëtarëve të minoriteteve për sa vijon:

- liria e shprehjes së identitetit;
- e drejta për themelimin e institucioneve dhe shoqatave vetjake;
- e drejta për mësim në gjuhën e tyre dhe e drejta e përdorimit të gjuhës së tyre si gjuhë zyrtare.

Me amendamentet e vitit 2001, disa prej të cilave u zunë në gojë më sipër, në KMVer ndryshon shprehja **pakicë**, që kishte qenë në përdorim nga vitit 1991, dhe futet në përdorim shprehja **komunitet**. Kjo është pasojë e **Marrëveshjes së Ohrit**, e cila, siç është vërejtur në literaturë, në tërësi ka ndryshuar modelin e demokracisë në **Maqedoninë e Veriut**, duke e kthyer në **demokraci konsociacionale**.[60] Kjo lloj demokracie ekziston edhe në Kosovë, por në një version më të theksuar se në Maqedoninë e Veriut.

Sipas amendamentit VIII rregullohen liritë dhe të drejtat e pjesëtarëve të komuniteteve në Maqedoninë e Veriut. Në këtë amendament, në disa paragrafë, përcaktohet se pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë për të shprehur, promovuar dhe zhvilluar identitetin e tyre dhe cilësitë e veçanta që kanë, përfshirë përdorimin e simboleve vetjake; Republika garanton mbrojtjen e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të të gjitha komuniteteve; pjesëtarët e bashkësive kanë të drejtë të themelojnë institucione kulturore, artistike, arsimore, si dhe shoqata shkencore dhe shoqata të tjera me qëllim të shprehjes, kultivimit dhe zhvillimit të identitetit të tyre; Pjesëtarët e bashkësive kanë të drejtë të ndjekin mësimin në gjuhën e tyre në arsimin fillor dhe të mesëm, në mënyrë të përcaktuar me ligj. Në shkollat në të cilat arsimimi zhvillohet në gjuhë tjetër, mësohet edhe gjuha maqedonase. Të gjitha këto liri dhe të drejta zbërthejnë parag. 1 të nenit 8 të KMVer, në të cilin radhiten vlerat kushtetuese që i mbron Maqedonia e Veriut si shtet. Ndër to llogaritet edhe të shprehurit e lirë të përkatësisë kombëtare.

Një operacionalizim tjetër është bërë me amendamentin V (2001), me të cilin është zëvendësuar neni i vjetër 7 i KMVer. Amendamenti ka të bëjë me gjuhën, përdorimin e saj në të gjitha nivelet e pushtetit, dhe përcakton se në tërë territorin e **Republikës së Maqedonisë** dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare, gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik. Gjuhë tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve, gjithashtu, është gjuhë zyrtare dhe alfabeti i saj. Dokumentet personale të qytetarëve, të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, lëshohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj, si dhe në atë gjuhë dhe alfabetin e saj në përputhje me ligjin. Cilido qytetar i cili jeton në njësitë e vetadministrimit lokal, në të cilën së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, në komunikim me njësitë rajonale të ministrive, mund ta përdorë cilëndo nga gjuhët zyrtare dhe alfabetin e

[60] Svetomir Skaric, *Ustavno pravo*. Osmo izdanje (KULTURA: Skopje, 2015) fq. 536 (libri është vetëm në gjuhën sllavo-maqedone, alfabeti cirilik).

saj. Njësitë rajonale kompetente për ato njësi të vetadministrimit lokal, përgjigjen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën zyrtare dhe alfabetin të cilin e përdorë qytetari. Çdo qytetar në komunikim me ministritë, mund ta përdorë njërën nga gjuhët zyrtare dhe alfabetin e saj, ndërsa ministritë përgjigjen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën zyrtare dhe alfabetin të cilin e përdorë qytetari. Në organet e pushtetit shtetëror në Maqedoninë e Veriut, gjuha zyrtare e ndryshme nga gjuha maqedonase, mund të përdoret në përputhje me ligjin. Në njësitë e vetadministrimit lokal gjuha dhe alfabeti që e përdorin së paku 20% e qytetarëve është gjuhë zyrtare, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik. Për përdorimin e gjuhëve dhe alfabeteve, në të cilat flasin së paku 20% e qytetarëve në njësitë e vetadministrimit lokal, vendosin organet e njësive të vetadministrimit lokal.

Një aspekt tjetër i mbrojtjes së komuniteteve pakicë normohet me amendamentin IX (2001) dhe ka të bëjë me një dimension tjetër të identitetit – dimensionin e ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore dhe historike të komuniteteve joshumicë.
Krejt kjo normativë kushtetuese është kurorëzuar me krijimin e Këshillit për marrëdhënie ndëretnike, me amendamentin IX në KMVer (2001). Në paragrafin e parë thuhet se "Republika e garanton mbrojtjen, përparimin dhe pasurimin e thesarit historik dhe artistik të Maqedonisë dhe të të gjitha bashkësive në Maqedoni të Veriut, si dhe të mirave që e përbëjnë atë, pa marrë parasysh regjimin e tyre juridik". Në të dytin, ndërkaq, tregohet se paragrafin e parë si më sipër zëvendësohet paragrafi 2 i nenit 56 të **KMVer**.

Nga kjo si më sipër shihet se amendamentet e vitit 2001 kanë kristalizuar pozitën dhe statusin juridik-kushtetues të komuniteteve joshumicë në këtë vend fqinj me Kosovën, si në preambulë ashtu edhe në pjesën operative. Në tekstin fillestar të **KMVer** të vitit 1991, gjendja e pakicave kombëtare dhe pakicave të tjera në Maqedoninë e Veriut ka qenë e tillë që ka lënë nën hije popujt joshumicë, duke përdorur sllavo-maqedonasit si parametër matës të sasisë dhe cilësisë së lirive dhe të drejtave të pakicave kombëtare dhe pakicave të tjera në këtë vend.

7.6.3. Të drejtat e minoriteteve dhe anëtarëve të tyre në Mal të Zi

Në **KMZi**, në pjesën mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, pjesa e dytë, është vënë një kapitull i posaçëm që normon të drejtat e posaçme - të drejtat e pakicave. Konstitucionalistët e Malit të Zi këtë sistemim kësisoj e arsyetojnë me faktin se pjesëtarët e pakicave kombëtare dhe pakicave të tjera kanë të garantuara të gjitha të drejtat kushtetuese, njëjtë sikur qytetarët tjerë malazez, krahas të drejtave dhe lirive të posaçme që ato mund t'i gëzojnë individualisht si pjesëtarë të komunitetit, por edhe në bashkësi pjesëtarët të tjerë të pakicave respektive. Këto të drejta e liri të posaçme vijnë si shprehje e karakterit multienik, multikonfesional dhe multiluturor në përgjithësi të Malit të Zi. Përveç kësaj, një qasje e tillë përbën edhe realizim të detyrimit kushtetues e ndërkombëtar të vendit, por edhe vetë traditës tolerante të Malit të Zi kundrejt diversitetit etnik, gjuhësor, fetar, kulturor dhe tjetër.[61] Ani se në nenin 2.1 të **KMZi** ky vend definohet si shtet qytetar, asgjë nuk ndryshon fakti që sanksionohen disa liri dhe të drejta të posaçme të pakicave, në rend të parë të pakicave kombëtare. Kjo sepse ky korpus i lirive dhe të drejtave, njëjtë si në Kosovë, vë baraspeshën civilizuese të nacionales dhe qytetares.[62]

Të drejtat e posaçme të pakicave në **KMZi** janë përmbledhur në dy vende:

- Mbrojtja e identitetit (neni 79); dhe
- Ndalimi i asimilimit (neni 80).

Në paragrafin e parë të nenit 79 thuhet se pjesëtarëve të popujve pakicë dhe pjesëtarëve të bashkësive të tjera nacionale u garantohen liri dhe të drejta që mund të shfrytëzohen individualisht apo

[61] Mladen Vukčević, *Komentar Ustava Crne Gore* (Univerzitet MediterN: Podgorica, 2015), fq. 201*;* Mijat Šuković, *Ustavno pravo* (CID: Podgorica, 2009), fq. 297-298.
[62] Mijat Šuković, *Ustavno pravo*, fq. 315; Mladen Vukčević*, Komentar Ustava Crne Gore*, fq. 203.

në bashkësi me të tjerët. Më pas numërohen me numër rendor, nga numri një deri te numri rendor trembëdhjetë. Si të tillë, këto përbëjnë esencën e mbrojtjes kushtetuese të identitetit të pakicave të këtë vend fqinjë me Kosovën.

- e para është e drejta e shprehjes, ruajtjes, zhvillimit dhe paraqitjes në publik të veçorive nacionale, etnike, kulturore dhe fetare;
- e drejta e dytë është e drejta e zgjedhjes dhe përzgjedhjes së simboleve nacionale, përdorimit të tyre në publik dhe me rastin e festave nacionale;
- e treta është e drejta e përdorimit privat, publik dhe zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave;
- e katërta është e drejta e shkollimit të institucione publike në gjuhën dhe shkrimin e pakicës, dhe që planet arsimore të përfshijnë historinë dhe kulturën e pakicave kombëtare dhe bashkësive të tjera nacionale pakicë;
- e pesta konsiston në përdorimin e gjuhës së pakicës nacionale dhe pakicës tjetër që përfaqëson një shumicë substanciale në administratën lokale, organet gjyqësore dhe organet shtetërore;
- e gjashta ka të bëjë me të drejtën për formimin e shoqatave arsimore, kulturore dhe fetare me ndihmën e shtetit;
- e shtata, që të shkruaj emrin dhe mbiemrin vetjak në dokumentet zyrtare;
- e teta, e drejta për emërtime në gjuhën e popullit pakicë apo në gjuhën e pakicës nacionale të rrugëve, emrave dhe krahinave lokale, përfshirë këtu shenjat topografike, të duhet të shkruhen në gjuhën amtare të pakicave;
- e nënta, përfaqësimi në kuvendin qendror të Malit të Zi dhe në kuvendet lokale të pakicave sipas parimit të veprimit afirmativ të shtetit;
- e dhjeta, lidhur me këtë, është e drejta e përfaqësimit proporcional në shërbimet publike, organet shtetërore dhe në organet e vetëqeverisjes lokale;
- e njëmbëdhjeta, e drejta për informimin në gjuhën amtare;
- e dymbëdhjeta, të vejnë dhe mbajnë kontakte me shoqatat jashtë Malit të Zi, me të cilat kanë prejardhje të përbashkët nacionale, etnike, kulturore-historike dhe bindje fetare; dhe, së fundi,
- e trembëdhjeta është e drejta për themelimin e këshillit për përparimin e të drejtave të posaçme.

Me dispozitat e nenit 80 të **KMZi** ndalohet **asimilimi i dhunshëm** i pjesëtarëve të popullit pakicë dhe pjesëtarëve të bashkësive të tjera nacionale (parag. 1). Shteti ka për detyrë që të mbrojë pjesëtarët e popujve pakicë dhe pjesëtarët e bashkësive të tjera nacionale nga çfarëdo lloj i asimilimit të dhunshëm (parag. 2).

Pjesëtarët e popujve pakicë dhe pjesëtarët e pakicave të tjera nacionale gëzojnë edhe çdo liri dhe të drejtë tjetër që u garantohet krejt qytetarëve të **Malit të Zi**. Kjo nënkupton se tërësia e lirive dhe të drejtave të pakicave në këtë vend përfshijnë dy fusha të veprimit dhe jetës njerëzore. Në njërën fushë ekzistojnë liritë dhe të drejtat e posaçme që sigurojnë se pakicat mund të ruajnë, shprehin lirshëm dhe zhvillojnë më tutje identitetin e tyre nacional dhe kulturor dhe të mbrohen nga asimilimi i dhunshëm. Kjo ka qenë një praktikë shumë e përhapur në Mal të Zi dhe në vendet tjera të Ballkanit në të kaluarën. Kjo nënkupton se asimilimi vullnetar nuk është i ndaluar. Në të njëjtën mënyrë, ruajtja e identitetit të pakicave nuk nënkupton që nuk mund dhe nuk duhet të bëhet koheziviteti social dhe integrimi në shoqëri.[63] Në fushën e dytë janë liritë dhe të drejtat që, së bashku me të drejtat e liritë e posaçme, mundësojnë ndërveprim dhe pjesëmarrje efektive të pakicave dhe pjesëtarëve të tyre në jetën publike dhe politike, në ushtrimin e pushtetit dhe vendosjen mbi punët e përgjithshme shoqërore. Në dy këto fusha, pjesëtarëve të popujve pakicë dhe të pakicave kombëtare nuk u takojnë vetëm liritë dhe të drejtat kushtetuese, por edhe ato që gjenden në parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, në marrëveshjet e ratifikuara dhe publikuara ndërkombëtare nga Mali i Zi.

[63] Mladen Vukčević, *Komentar Ustava Crne Gore*, fq. 207 *(*duke cituar një vendim të Gjykatës Kushtetuese të këtij vendi, autori thotë se mësimi i gjuhës malazeze nuk përbën asimilim të dhunshëm dhe i shërben integrimit dhe kohezivitetit social të përgjithshëm të vendit).

7.6.4. Të drejtat e minoriteteve dhe anëtarëve të tyre në Serbi

Edhe në **KSerb**, si në vendet tjera përreth Kosovës, në aspektin formalo-juridik, pakicave u garantohen të gjitha liritë dhe të drejtat e njeriut, sikur qytetarëve të tjerë. Krahas kësaj, edhe në aktin më të lartë juridik serb ekzistojnë dispozita të posaçme, të cilat pakicave u garantojnë të drejta e liri shtesë, individuale dhe kolektive. Nenet 75 – 81 të **KSerb.**, të cilët i takojnë kapitullit të tretë të pjesës së dytë, megjithatë, dallojnë nga dispozitat mbi pakicat e vendeve përreth vendit tonë sepse bëjnë fjalë vetëm për pakicat kombëtare. Vetë titulli i kapitullit të tretë të pjesës së dytë titullohet "Të drejtat e pjesëtarëve të pakicave kombëtare". Në këtë kuptim, shoqëria serbe ka ruajtur standardin klasik të definimit të pakicave, duke pasur si parametër vetëm përkatësinë nacionale dhe, në të njëjtën kohë, duke injoruar diversitetin tjetër kulturor, etnik, gjuhësor, fetar dhe tjetër që, pa dyshim, ekziston në Serbi. Të drejtat e pakicave në Serbi nuk garantohen vetëm me KSerb., por edhe duke u bazuar në ligj dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Të drejtat individuale realizohen në mënyrë vetjake, individualisht, kurse ato kolektive në bashkësi me pjesëtarët tjerë të pakicës kombëtare (neni 75 parag. 1). Një mbrojtje të veçantë, jashtë dispozitave të kapitullit të tretë të pjesës së dytë të **KSerb**., e hasim në nenin 14 parag.2., që thotë se Shteti garanton realizimin e barazisë së plotë dhe ruajtjen e identitetit të pakicave kombëtare. Paragrafi i parë i të njëjtit nen, që gjendet në parimet themelore të **KSerb**., thotë gjithashtu se "Republika e Serbisë mbron të drejtat e pakicave kombëtare". Një garancion tjetër, që gjendet në pjesën e parimeve themelore të pjesës së dytë të KSerb., shprehimisht përcakton se nuk mund të zvogëlohet niveli i arritur i lirive dhe të drejtave të pakicave kombëtare (neni 20 parag. 2). Ky nen si tërësi rregullon kufizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, kur dhe si mund të ndodh një gjë e tillë. Në fakt, titulli i këtij neni është "Kufizimi i të drejtave të njeriut dhe të pakicave" dhe është në harmoni të plotë me vetë titullin e pjesës së dytë të KSerb., që është: "Të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të pakicave".

Pjesëtarët e pakicave kombëtare, të drejtat kolektive i realizojnë në fushat e kulturës, arsimit, informimit dhe përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit, drejtpërdrejtë ose me vendosje përmes përfaqësuesve të tyre (neni 75 parag. 2). Me qëllim të realizimit të vetëqeverisjes në këto fusha, pjesëtarët e pakicave kombëtare mund të formojnë këshillat e tyre nacionale (neni 75 parag. 3). Kjo vetëqeverisje e pakicave realizohet në pajtim me ligjet sektoriale, siç janë, ta zëmë: ligji për përdorimin e gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare, ligji mbrojtjen e lirive dhe të të drejtave të pakicave kombëtare, ligji për këshillat e pakicave kombëtare, ligji për kulturën, arsimin, informimin publik dhe kështu me radhë.

Në **KSerb** ndalohet çfarëdo diskriminimi për shkak të përkatësisë pakicës së caktuar kombëtare, krahas ndalimit të diskriminimit të përgjithshëm, kurse nuk konsiderohen diskriminim dispozitat dhe masat e posaçme - diskriminimi pozitiv dhe masat e veprimit afirmativ, të cilat mund të ndërmerren nga Shteti serb në sferën e jetës ekonomike, shoqërore, kulturore dhe politike. Këto dispozita dhe masa miratohen, përkatësisht ndërmerren me qëllim të arritjes së barazisë së plotë të pakicave me popullin shumicë dhe duhet të jenë të drejtuara kah evitimi i kushteve veçanërisht të pavolitshme të jetës që posaçërisht godasin pakicat (neni 76).

Te drejtat konkrete të pakicave kombëtare janë të shumta. Secili pjesëtar i pakicës kombëtare ka të drejtë të marrë pjesë, nën kushte të barabarta me qytetarët tjerë, në drejtimin e punëve publike dhe të hyj në funksione publike. **KSerb** një kujdes të veçantë i ka kushtuar përfaqësimit të pakicave kombëtare në punësim në organet e pushtetit shtetëror, krahinor dhe lokal dhe në shërbimet publike, dhe atë marrë parasysh përbërjen nacionale të popullsisë në atë zonë (neni 77).

Dy ndalesa përbëjnë, në këtë kuptim, thelbin e mbrojtjes absolute të lirive dhe të drejtave të pakicave kombëtare. E para ka të bëjë me ndalimin e asimilimit të dhunshëm, që me rrugë artificiale pjesëtarët e pakicës kombëtare të shndërrohen në pjesëtarë të popullit shumicë, përmes ndërmarrjes së masave administrative, siç janë ta zëmë, ndryshimi i emrave personalë. E dyta ka të bëjë me ndalimin e ndërmarrjes së masave përmes të cilave, në rrugë artificiale, ndryshohet përbërja nacionale e popullsisë në vendet ku pakicat tradicionalisht kanë jetuar në numër të konsiderueshëm (neni 78). Kjo nënkupton ndalesën që, përmes orga-

nizimit shtetëror, të bëhet shpërngulja masive e pjestarëve të kombeve të tjera në fshatarë, qytete ose rajone më të gjëra.

Në nenin 79, që titullohet ”E drejta për ruajtjen e veçantësisë”, normohen një sërë të drejtash dhe lirish për pakicat kombëtare, siç janë:

- e drejta për shprehjen, ruajtjen, kultivimin dhe zhvillimin e veçantësisë nacionale, etnike, kulturore dhe fetare; e drejta për përdorimin e simboleve të veta në vendet publike;
- e drejta për përdorimin e gjuhës dhe shkrimit amtar;
- e drejta që, në vendet ku përbëjnë një shumicë substanciale, organet shtetërore, organizatat që kryejnë autorizime publike, organet e krahinave autonome dhe njësive të vetëqeverisjes lokale të zhvillojnë procedurën në gjuhën e pakicës;
- drejta për shkollim në gjuhën amtare në institucionet shtetërore dhe në institucionet e krahinave autonome; e drejta për themelimin e institucioneve private të arsimit; e drejta që në gjuhën amtare të përdorin emrin dhe mbiemrin;
- e drejta që në vendet ku janë shumicë substanciale, emërtimet tradicionale lokale, emrat e rrugëve, lagjeve dhe shenjat topografike të shkruhen edhe në gjuhën e pakicave;
- e drejta për informim të plotë, me kohë dhe në mënyrë të paanshme në gjuhën amtare, përfshirë të drejtën për shprehje, marrje, dërgim dhe këmbim të ideve dhe informatave;
- e drejta për themelimin e mjeteve të tyre të informimit publik, në pajtim me ligjin.

Në pajtim me **KSerb**, bazuar në ligj, me dispozita krahinore mund të krijohen të drejta shtesë për pjesëtarët e pakicave kombëtare.

Pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtë që të bashkohen në shoqata arsimore dhe kulturore që i financojnë vetë, në ndërkohë që shteti këtyre shoqatave ua njeh rolin e posaçëm në realizimin e të drejtave të pakicave. Kjo do të thotë se në një pjesë edhe i financon ato. Pjesëtarët e pakicave kanë të drejtë për kontakte të papenguara dhe bashkëpunim me bashkëkombësit e tyre në vendet amë dhe në shtetet tjera, përmes shoqatave kulturore dhe arsimore apo në mënyra të tjera (neni 80).

Lidhur me arsimin, kulturën dhe informimin e të gjithëve, pra edhe të pjesëtarëve të pakicave kombëtare, kushtetutëbërësi serb në veçanti ka theksuar detyrimin e shtetit për zhvillimin e shpirtit të tolerancës - respektimi, mirëkuptimi dhe bashkëpunimi mes të gjithëve, pa marrë parasysh identitetin etnik, fetar, kulturor dhe gjuhësor (neni 81).

Sikundër shihet, dispozitat e nenit 79 dhe 81 të **KSerb janë të vetmet** që bëjnë fjalë edhe për diversitetin tjetër kulturor, gjuhësor, fetar dhe etnik, jo vetëm për diversitetin nacional.

8. Komente dhe pyetje

8.1. Koncepti i lirive dhe të drejtave të njeriut ka mangësitë e veta, dy ndër të cilat janë më kryesoret. Diskutoni!

8.2. Nga periudha e revolucionit amerikan, duhet të shkëputen për analizë **Deklarata e të Drejtave e Shtetit Virxhinia dhe Deklarata e Pavarësisë.** Diskutoni!

8.3. **Deklarata e të drejtave të njeriut** dhe qytetarit është burimi më i rëndësishëm i lirive dhe të drejtave të njeriut në territorin e Evropës, me rëndësi universale: nën ndikimin e saj, siç e ka thënë **Xh. Jellinek**, të drejtat individuale janë kthyer në të drejta pozitive të vendeve evropiane. Diskutoni!

8.4. Dy pakte ndërkombëtare në mënyrë të detajuar përpunojnë dispozitat e **DUDNJ-së**, duke marrë më shumë parasysh mundësitë reale për realizmin të lirive dhe të drejtave të njeriut. Me to normohen të drejtat e individit dhe të drejtat kolektive dhe, për dallim nga Deklarata Universale, përbëjnë burim të së drejtës. Për cilat pakte bëhet fjalë?

8.5. Me **PDCP-në** themelohet **Komiteti për të Drejtat e Njeriut.** Çka është ky trup dhe cilat janë kompetencat e tij? A ka kompetenca ekzekutive?

8.6. Krahas **PDCP-së** ekzistojnë protokollet shtesë, të cilave mund t'iu bashkohet shtetet palë të tij. Ekzistojnë dy sosh dhe janë opsionale, njëri nga vitit 1966 dhe tjetri nga vitit 1989. Çka është arritur me këto dy protokolle shtesë?

8.7. Me protokollin opsional të vitit 2008, shtetet palë pranojnë kompetencën e **Komitetit për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore** për të përcjellë zbatimin e **PDESK-së** dhe për këtë të bëjnë raport pesëvjeçar. Çka është ky trup dhe cilat janë kompetencat e tij? A ka kompetenca ekzekutive?

8.8. Në truallin evropian, pra, konventat dhe dokumentet tjera në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut kanë pozitë dhe rol tjetër në sistemet nacionale të vendeve anëtare të KE-së dhe BE-së. Më e rëndësishmja ndër to është **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut** (KEDNJ) e vitit 1950. Kjo Konventë fuqishëm mbështetet në **DUDNJ** dhe përcakton detyrimin e shteteve palë që të respektojnë liritë dhe të drejtat e garantuara me të. Diskutoni!

8.9. Liritë dhe të drejtat e njeriut janë pjesë përbërëse e kushtetutës. Në këtë kuptim, sipas materies që kryesisht normohet me kushtetutë, në historinë kushtetuese krahasimore mund të dallohen dy lloje të normimeve kushtetuese. Diksutoni!

8.10. Në historinë kushtetuese të konstitucionalizmit francez, liritë dhe të drejtat e njeriut nuk kanë qenë tradicionalisht në kuadër të tekstit kryesor kushtetues, por janë rregulluar me deklarata mbi të drejtat. Deklarata e vitit 1789, si dokument kushtetues që normon liritë dhe të drejtat e njeriut, është pjesë e preambulave të dy kushtetutave të fundit franceze. Diskutoni!

8.11. Zakonisht ku gjenden të sistemuara dispozitat kushtetuese mbi liritë dhe të drejtat e njeriut?

8.12. **Xhorxh Jellinek** ka krijuar kategorinë e të **drejtave subjektive publike**. Çfarë nënkuptohet me këtë kategori?

8.13. Sipas rolit që kanë qytetarët në shtet dhe anasjelltas, sipas rolit që shteti ka ndaj tyre ekzistojnë **liritë dhe të drejtat e statusit aktiv** dhe **liritë dhe të drejtat e statusit pasiv**. Çfarë do të thotë njëra e çfarë tjetra kategori?

8.14. E ngjashëm me ndarjen si më sipër, gjithnjë sipas **Xh. Jellinek**, është ajo që ndan liritë dhe të drejtat në **liri dhe të drejta të statusit pozitiv** dhe **liri e të drejta të statusit negativ**. Çfarë nënkuptohet më njërin lloj e çfarë me tjetrin?

8.15. Sipas asaj se kush është bartës i të drejtës (me kënd kanë të bëjnë), liritë dhe të drejtat mund të ndahen në liri dhe të drejta të **njeriut**, **qytetarit** dhe **shtetasit.** Çfarë do të thotë kjo dhe kur ka nisur ky dallim për herë të parë?

8.16. Liritë dhe të drejtat e njeriut mund të klasifikohen në **liri dhe të drejta individuale** dhe **liri e të drejta kolektive**, sipas asaj se kush është bartës i tyre. Diskutoni!

8.17. Sipas vlerës që mbrohet, liritë dhe të drejtat e njeriut mund të ndahen në **liri dhe të drejta personale, liri dhe të drejta politike, liri dhe të drejta sociale, ekonomike dhe kulturore, liri dhe të drejta që u takojnë pakicave të ndryshme** (kombëtare, fetare, gjuhësore, bazuar në orientimin seksual dhe kështu me radhë) dhe, së fundi, **liritë dhe të drejtat e të huajve**. Diskutoni!

8.18. Sipas kohës së pranimit dhe garantimit të tyre, në fillim liritë dhe të drejtat e njeriut janë ndarë në **tri kategori**. Diskutoni!

8.19. Për dallim nga dy gjeneratat si më sipër që fokusohen në liri dhe të drejta individuale, gjeneratat tjera më shumë kanë të bëjnë me kolektivitete apo grupime abstrakte njerëzore si përfitues të tyre. Diskutoni!

8.20. **Barazia** është kusht dhe parim i realizimit të lirive dhe të drejtave të njeriut. Diskutoni!

8.21. Dispozitat mbi barazinë e njerëzve gjejnë vendin e tyre në kushtetuta nacionale dhe atë duke përdorur si pikë nisëse për rregullimin dhe realizimin e të drejtave, lirive dhe detyrave të tjera. Kjo barazi përpunohet përmes rregullave mbi barazinë para ligjit, gjyqëve, barazinë e votës dhe ndalimi i diskriminimit. Çfarë nënkupton kjo?

8.22. Liritë dhe të drejtat e njeriut realizohen nëse ekziston respektimi i **ndalimit të keqpërdorimit dhe mundësia e kufizimit** të tyre.

8.23. Çka është suspendimi e çka kufizimi i lirive dhe të drejtave të njeriut?

8.24. Çka nënkuptohet me shprehjen **ligjshmëria e kufizimit** apo **suspendimit** të lirive dhe të drejtave të njeriut?

8.25. Çka nënkuptohet me shprehjen **legjitimiteti i kufizimit** apo **suspendimit** të lirive dhe të drejtave **t**ë njeriut?

8.26. E drejta ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe e drejta kushtetuese e shteteve sovrane dhe të pavarura njohin mundësinë e **shmangies** nga standardi i lirive dhe të drejtave njerëzore në rrethanat e ekzistimit të gjendjes së jashtëzakonshme (lufta ose rrezik tjetër publik që kërcënon ekzistencën e kombit). Diskutoni!

8.27. Mbrojtja e lirive dhe të drejtave nga **avokati i popullit** nuk është mbrojtje juridike, por mbrojtje në procedurat për realizimin e lirive dhe të drejtave njerëzore nga padrejtësitë e mëdha dhe të vogla, nga zvarritjet, joefikasiteti dhe pasiviteti i organeve të administratës dhe subjekteve të tjera që ushtrojnë autorizime publike. Cilat janë format e mbrojtjeve juridike?

8.28. Nga fakti se liritë dhe të drejtat e njeriut kanë natyrë universale, mbrojtja e tyre nuk bëhet vetëm në brenda shteteve. Krahas kësaj ekziston edhe **mbrojtja ndërkombëtare**, e cila bazohet në rekomandimet dhe vendimet e trupave dhe gjykatave ndërkombëtare. Për çfarë bëhet fjalë këtu?

8.29. Sistemi evropian i mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut bazohet në **KEDNJ** dhe në punën e vyeshme dhe shumë produktive të **GJEDNJ-së**. Çka dallon kjo mbrojtje nga mbrojtjet tjera të lirive dhe të drejtave të njeriut që kryhen në kuadër të sistemit të OKB-së, bazuar në instrumentet dhe aktet juridike të miratuara nën ombrellën e saj?

8.30. Sipas **objektit** apo **të mirës** që mbrojnë, këto liri dhe të drejta mund të grupohen në disa tërësi. Për çfarë bëhet fjalë këtu?

8.31. A është e drejta për jetë një **e drejtë absolute** aty ku ekziston dënimi me vdekje?

8.32. Kur ka ardhur deri të heqja përfundimtare **e dënimit me vdekje** në truallin evropian?

8.33. Në të drejtën e brendshme, **e drejta për jetë** garantohet me kushtetutë nacionale. Mbi bazën e garancioneve që ofrohen, zgjidhjet kushtetuese të shteteve mund të grupohen në disa grupe. Cilat janë këto grupe? Diskutoni!

8.34. Përveç dënimit me vdekje, që përfaqëson mënyrën e ligjshme të privimit nga jeta të një personi nga ana e shtetit, si çështje kontestuese lidhur me të drejtën për jetë lajmërohen edhe **e drejta për abortim** dhe **e drejta në eutanazi**. Diskutoni!

8.35. Si pjesë e lirisë personale janë të drejtat e personalitetit të secilit person mbrohen në mënyrë të veçantë në shtetet bashkëkohore. Diskutoni këtë kategori në kontekstin e të drejtës për të qenë i lirë!

8.36. Cilat janë arsyet që çojnë në kufizimin e lirisë së lëvizjes?

8.37. Cilat janë rastet në të cilat kufizohet liria e lëvizjes për të huajt?

8.38. A konsiderohen kufizime të lirisë së lëvizjes rregullativat "teknike" që normojnë lëvizjen e njerëzve, siç janë vozitja në anën e djathtë, ecja në trotuar, kalimi për këmbësor, rregullimi komunikacionit me semaforë dhe rregulla të tjera si këto?

8.39. **Liria e vendosjes** përfshinë **të drejtën në vendqëndrim** (vendosja e përkohshme) dhe **të drejtën për vendbanim** (domicil apo vendosjen e përhershme). Cilat kategori të personave gëzojnë këtë të drejtë?

8.40. Brenda lirisë së mendimit dhe shprehjes mund të dallohen dy procese dhe veprime. Diskutoni!

8.41. Nëpër kushtetua, liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë rregullohet në vartësi të asaj se çfarë marrëdhënie kanë shtetet me kishën dhe bashkësitë fetare dhe të besimit, përkatësisht nëse shteti është ateist, fetar apo laik (sekular). Cilat janë modelet e marrëdhënies së fesë dhe shtetin aktualisht?

8.42. Në shtetet bashkëkohore janë imponuar dy lloje të arsyeve për shkak të të cilave ka ardhur deri te ngushtimi i të drejtave të privatësisë, shkelja dhe zhvlerësimi i tyre. Diskutoni!

8.43. Çfarë është me rëndësi te kufizimi i fshehtësisë së korrespondencës?

8.44. Mbrojtja e jetës private nënkupton që çdo kush ka të drejtë që veprimet dhe marrëdhëniet private, me fillim nga ato më të zakonshme, të karakterit të përditshëm (ushqimi, daljet, shëtitjet, puna, shitblerjet etj.) e deri te orientimi seksual, t'i ruaj nga publiku dhe dijenia e personave të tretë. Diskutoni!

8.45. Në këtë grupim të veçantë të lirive dhe të drejtave të njeriut futen liritë dhe të drejtat që mbrojnë pozitën e individin në procedura gjyqësore. Diskutoni?

8.46. A mund të hiqet dorë në kohë të gjendjes së jashtëzakonshme nga të drejtat që përbëjnë të drejtën për gjykim të drejtë?

8.47. Ekzistojnë disa të drejta që përbëjnë të drejtën për gjykim të drejtë: **e drejta për gjykatë të pavarur, të paanshëm dhe ligjor ka disa elemente.** Diskutoni!

8.48. E drejta zgjedhore është e drejtë themelore politike. Një status të tillë e ka sipas akteve ndërkombëtare dhe në kushtetutat nacionale, sepse zgjedhjet janë bazë e legjitimitetit të pushtetit. E drejta zgjedhore definohet si e drejtë e qytetarit për të zgjedhur organet e pushtetit (**e drejta zgjedhore aktive**, zotësia zgjedhore) dhe e drejta për të qenë i zgjedhur në ato organe (**e drejta zgjedhore pasive**, zotësia për përfaqësim). Diskutoni!

8.49. Shtypi i lirë është i domosdoshëm për ekzistencën e konstitucionalizmit siç e njohim sot. Një thënie franceze thotë: "Më merrni krejt liritë, ma leni vetëm lirinë e shtypit dhe do të shini që do t'i rikthej të gjitha liritë e marra". Çfarë ka thënë **Mirabo** për këtë?

8.50. Liria e asociimit si **e drejtë politike** ka të bëjë me themelimin e bashkimeve dhe organizatave politike. Çfarë do të thotë kjo?

8.51. **Lirinë e asociimit politik**, megjithatë, nuk e gëzojnë të gjithë individët. Dsikutoni!

8.52. **Liria e asociimit** garantohet së bashku me **lirinë e tubimit**. Përkundër asaj që bëhet fjalë për liri të ngjashme, që nënkuptojnë shprehjen e mendimit dhe ndërmarrjen e veprimeve me qëllim të arritjes së qëllimit të caktuar politik, ato, megjithatë, nuk janë të njëjta. Diskutoni!

8.53. Nga fund të shekullit IX vjen deri të ndryshimi i rolit dhe natyrës së shtetit. Kjo ka shkaktuar pasoja në një drejtim të caktuar, sa i përket lirive dhe të drejtave të njeriut. Për çfarë bëhet fjalë?

8.54. Janë miratuar akte ndërkombëtare që globalisht dhe regjionalisht rregullojnë **të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore**. Qëllimi i tyre është përmirësimi standardit jetësor të qytetarit dhe përparimi i mirëqenies së përgjithshme shoqërore në vendet që i kanë përqafuar. Para tyre kanë ekzistuar deklarata e kushtetuta, me të cilat janë garantuar këto liri dhe të drejta, u mor vesh jo shkallën që sot garantohen. Cila kushtetutë merret si kushtetutë e parë e këtij lloji dhe çfarë dispozitatsh socio-ekonomike e kulturore ka përmbajtur?

8.55. **E drejta për punë**, në kuptimin e ngushtë të fjalës, është e drejtë deklarative, sepse shteti nuk ka detyrim sigurimin e punës për çdo kënd. Çfarë nënkupton kjo natyrë e të drejtës për punë?

8.56. E drejta për punë është një e drejtë komplekse njerëzore, që përbëhet nga disa të drejta dhe liri. Cilat janë ato të drejta?

8.57. Në çfarë konsiston specifika e të drejtave të punës dhe që lidhet me kontratat kolektive?

8.58. E drejta për mbrojtjen e shëndetit bën pjesë në ato të drejta, realizimi i të cilave në masë të madhe varet nga shteti. Dallohen dy kushte për realizmin e plotë të kësaj të drejte. Cilat janë ato?

8.59. Detyrat kushtetuese nuk janë të shumta, siç janë liritë dhe të drejtat e njeriut. Diskutoni!

8.60. Ato të drejta që u garantohen vetëm shtetasve të vendit janë **të drejta politike**. Çfarë nënkupton kjo?

8.61. Në marrëveshje e traktate ndërkombëtare garantohet e drejta për shtetësi. Kushtetutat garantojnë të drejtën për shtetësi, në mesin e lirive dhe të drejtave njerëzore. Këto të fundit, e bëjnë këtë në mënyrë të detajuar dhe konkrete apo e normojnë këtë të drejtë vetëm në nivel parimor (të përgjithshëm)?

8.62. Çka nënkuptohet me **diskriminim pozitiv** kundrejt pakicave e çka me **veprim afirmativ** të shtetit, gjithnjë në kontekst të mbrojtjes së pakicave?

8.63. **DUDNJ** nuk garanton të drejtat e pakicave kombëtare dhe pakicave të tjera. Këtë e bënë PDCP-ja në nenin e vet 27. Pse?

8.64. Cili është dokumenti më i rëndësishëm evropian për mbrojtjen e pakicave dhe çfarë përmban ai?

8.65. Çfarë nënkuptohet me **autonomi kulturore** e çfarë me **autonomi territoriale**?

8.66. Kapitujt dy dhe tre të **KKos** në tërësi i kushtohen lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve të Kosovës. U mor vesh, dispozitat e kësaj materie kushtetuese gjenden edhe në pjesët tjera të KKos. Diskutoni!

8.67. E drejta për shtetësi nënkupton mbrojtje të veçantë kushtetuese. Në çfarë konsiston kjo veçanti?

8.68. Lidhur me realizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, në **Kushtetutën e Maqedonisë së Veriut** bie në sy mungesa e mbështetjes së fuqishme në burime të së drejtës ndërkombëtare, situatë e kundërt me Kosovën dhe deri diku me Shqipërinë. Gjithashtu, sa i përket interpretimit të burimeve të së drejtës

ndërkombëtare, në tërësi vlejnë rregullat e të drejtës së brendshme maqedonoveriore dhe nuk ekziston një detyrim për mbështetje në praktikën dhe standardet ndërkombëtare, në veçanti në standardet dhe praktikën e GJEDNJ-së. Pse?

8.69. Zgjidhjet kushtetuese në Kosovë sa i përket gjendjes së jashtëzakonshme dhe shmangies nga liritë dhe të drejtat e njeriut janë të ngjashme me vendet tjera përreth Kosovës. Cilat janë zgjidhjet kushtetuese në Kosovë sa i përket shmangies nga liritë dhe të drejtat e njeriut në kohën e gjendjes së jashtëzakonshme?

8.70. Parametrat që duhet të marr parasysh ligjvënësi malazez, që formojnë **parimin e proporcionalitetit,** janë për sa vijon: kufizimi duhet të bëhet me ligj, të ndjek një qëllim legjitim, të jetë i domosdoshëm dhe në masë të duhur për një shoqëri demokratike dhe mos të ndjek qëllim apo synim tjetër nga ai për të cilin është vënë kufizimi. Cili kriter nuk figuron këtu dhe që gjendet në të gjitha kushtetutat përreth Kosovës? Kriter që mungon në KMZi, a përbën standard evropian dhe a mund të nënkuptohet se është prezent në te?

8.71. Autorizimet e organeve qendrore kushtetuese janë, në thelb, të njëjta në kushtetutat e të gjitha vendeve fqinje me Kosovën, përfshirë vetë Kosovën. Njëri prej organeve qendrore ka rolin parësor në caktimin e kufizimeve ndaj lirive dhe të drejtave kushtetuese si dhe vëllimet e këtyre kufizimeve, gjithnjë duke u bazuar në kushtetutë e ligj. Diskutoni këto zgjidhje kushtetuese dhe rolin e organeve qendrore në kohën sa zgjat kjo gjendje, veçanërisht në dritën e lirive dhe të drejtave të njeriut!

8.72. Në disa kushtetuta, e drejta për ankesë veçohet si e drejtë e posaçme, në ndërkohë që në Kosovë bëhet fjalë për mjete juridike në kuptim të të gjitha mjeteve ekzistuese dhe joekzistuese: Shteti duhet të garantojë mjete juridike efektive për qytetarët dhe subjektet tjerë të së drejtës për realizimin e të drejtave të tyre. Kjo është esenca e nenit 32 të **KKos**, që në nenin pararendës shpaloset kryesisht në kontekstin e procedurës penale. Kjo është kështu sepse, më së shpeshti, në procedurën penale vjen deri te cenimi i lirive dhe të njerëzore, shikuar historikisht. Për pasojë, ekziston nevoja që, siç bëjnë kushtetutat bashkëkohore, të përcaktohen garancione të qarta kushtetuese të natyrës penalo-juridike në dobi të të akuzuarit. Cilat janë ato?

8.73. Si definohet Kosova në çështjet fetare?

8.74. Nisur nga fakti se **familja** gëzon mbrojtje të veçantë të shtetit, në pajtim me ligjin, kjo përfshinë edhe prindërit e divorcuar dhe fëmijët. Sipas rregullit, pikërisht për këtë arsye, **KKos** është dashur të garantojë edhe një pozitë të posaçme të nënës, para dhe pas lindjes, si dhe të garantojë të drejta të posaçme të fëmijëve. Për çka bëhet fjalë këtu?

8.75. Çka është **e drejta e peticionit** dhe a garantohet me **KKos**?

8.76. Jo rrallë, në kushtetuta, përfshirë disa prej vendeve fqinje me vendin tonë, por jo edhe vetë vendin tonë, përcaktohen kushte të posaçme dhe mbrojtje e veçantë për gratë, të miturit dhe të rinjtë. Edhe këto garancione, më pas, në mënyrë të detajuar normohen me ligj. Diskutoni si është e rregulluar kjo në vendet fqinje me Kosovën.

8.77. A garanton **KKos** të drejtën për grevë?

8.78. **KKos** nuk garanton shprehimisht as **të drejtën e ndërmarrësisë**, siç e bëjnë kushtetutat e disa vendeve fqinje, përkundër që në mënyrë të veçantë flet për pluralizëm ekonomik dhe të pronës, përkatësisht për marrëdhënie ekonomike të bazuara në tregun e lirë, lirinë e aktivitetit ekonomik dhe sigurinë e pronës publike e private. Diskutoni!

8.79. Shteti që kultivon drejtësinë sociale nuk është i barasvlershëm me të qenët **shtet social**. Gjendja e fundit, që ekziston në disa vende, ta zëmë në **Gjermani**. Çka do të thotë kjo?

8.80. Në **të drejtat e para sociale**, dhe të vetmet, hyjnë ato që normohen me nenin 51 të **KKos** dhe që përfshijnë, në dy paragrafë, mbrojtjen shëndetësore dhe sociale. Diskutoni!

8.81. A garanton **KKos** autonominë e universitetit? Si është kjo e rregulluar në kushtetutat e vendeve fqinje me Kosovën?

8.82. Në kuadër të lirive dhe të drejtave t**ë gjeneratës së tretë, KKos** bënë fjalë vetëm për njërën prej tyre. Në fakt, ajo as nuk e formulon si një liri ose të drejtë njerëzore, por si një përgjegjësi të posaçme. Për çfarë bëhet fjalë?

8.83. Konceptualisht, nuk ka asnjë dallim në mes të zgjidhjeve kushtetuese shqiptare dhe atyre të Kosovës,

sa i përket mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut. Diskutoni!

8.84. Nenet 21 deri 44 të kreut të dytë **KShq** i kushtohen lirive dhe të drejtave personale, të cilat kushtetutëbërësi shqiptar i quan liri dhe **të drejta vetjake**. Ky kapitull nis me të drejtën për jetë, të cilën çuditërisht e garanton përmes ligjit: Jeta e personit mbrohet me ligj, thotë fjalia e vetme e nenit 21 të **KShq**. Sipas këtij redaktimi të kësaj dispozite del sikur me ligj mund të caktohet dënimi me vdekje dhe format tjera të marrjes së jetës së njeriut (lufta, gjendja e jashtëzakonshme në të gjitha trajtat e saj dhe kështu me radhë). Kjo, megjithatë, nuk është kështu. Pse?

8.85. Trajtimi i pronës në **KShq** është shumë më i plotë se në Kosovë dhe i përafërt me standardet evropiane mbi pronën të përcaktuara nga **KEDNJ**-ja dhe protokollet e saj dhe praktika e **Strasburgut**. Pse?

8.86. Neni 42 i **KShq**, në dy paragrafë normon dy kategori të drejtave: të drejtën për gjykim të rregullt (paragrafi i parë) dhe të drejtën për gjykim në kohë të arsyeshme. A ekziston në **KKos** kjo e fundit?

8.87. Në Kosovë duhet që të drejtat zgjedhore pasive të merren me vendim nga gjykata kompetente, kurse në Shqipëri normohen tri situata që përbëjnë përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i të drejtës zgjedhore. Cilat janë ato tri situata?

8.88. **Objektivat socialë** nga neni 59 i **KShq** janë një zgjidhje unikate kushtetuese në rajon: në dy paragrafë, por në një vend të vetëm, aty shpalosen synimet e Shtetit shqiptar në disa fusha. Diskutoni!

8.89. Konceptualisht, nuk ka ndonjë dallim në mes të zgjidhjeve kushtetuese në Maqedoninë e Veriut dhe Kosovës e Shqipërisë, sa i përket mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut. Megjithatë, ekziston një dallim i vogël. Cili është ai? Diskutoni ngjashmëritë tjera në mes të zgjidhjeve kushtetuese në dy vendet, sa i përket mbrojtjes së lirive dhe të drejtave kushtetuese.

8.90. Garantimi i **të drejtës për jetë në KMVer** është më i qartë se në **KShq**. Pse?

8.91. Edhe **e drejta e lirisë** është shumë më e varfër në përmbajtje, krahasuar me KKos: në **KMVer** nuk jepen bazat e heqjes së lirisë. Ato baza i cakton ligjvënësi maqeodnoverior. Çfarë do të thotë kjo?

8.92. Në vendet përreth Kosovës, përjashtim të KShq, ekzistojnë dispozita specifike lidhur me natalitetin. Për Çfarë bëhet fjalë?

8.93. Diskutoni detyrimet kushtetuese të qytetarëve në kushtetutat e vendeve fqinje me Kosovën dhe krahasoni ato me **KKos**.

8.94. Në **KMVer** nuk ekziston ndonjë kategori e lirive dhe të drejtave për anëtarët e komuniteteve pakicë që jetojnë në këtë vend. **Marrëveshja e Ohrit**, e lidhur më 13 gusht 2001 në mes të shqiptarëve dhe pushtetit të Maqedonisë së Veriut të asaj kohe, me të cilën u ndal lufta dhe konflikti i armatosur mes shqiptarëve dhe forcave ushtarako-policore të këtij vendi (janar – gusht 2001), përbën një përjashtim nga kjo rregull. Diskutoni se cilat kanë qenë ndryshimet kushtetuese në KMVer si pasojë e kësaj marrëveshjeje!

8.95. Në **KSerb** nuk gjenden dispozitat e çuditshme, si në KMZi dhe KMVer, që shpallin të lejueshme çdo gjë që nuk ndalohet me kushtetutë e me ligje. Në mënyrë të ngjashme me KKos, në nenin 23 parag. 1 të **KSerb dinjiteti i njeriut** merret si themel i lirive dhe të drejtave të njeriut, të cilin të gjithë duhet ta respektojnë.

8.96. Të drejtat e të huajve në **KKos** nuk janë të sistematizuara në një vend, siç ndodhë në disa kushtetuta të vendeve të huaja. Përveç kësaj, në **KKos** nuk ekziston asnjë dispozitë që definon pozitën kushtetuese të të huajve, siç e bëjnë disa prej kushtetutave të vendeve fqinje me Kosovën. Si definohet pozita kushtetuese e të huajve në vendet fqinje me Kosovën?

8.97. Edhe në **KShq**, të drejtat e të huajve nuk janë të sistematizuara në një vend. Për dallim nga KKos, në rastin e KShq ekziston një dispozitë e përgjithshme që definon pozitën kushtetuese të të huajve. Çfarë thuhet në atë dispozitë?

8.98. Liritë dhe të drejtat e të huajve dhe personave pa shtetësi në **KMVer** nuk janë të sistematizuara në një vend. Për dallim nga rasti i KKos, në KMVer ekziston një dispozitë, ngjashëm si në KShq., që definon pozitën kushtetuese të të huajve dhe personave pa shtetësi. E kemi fjalën për dispozitën e nenit 29.1 të **KMver**. Çfarë thuhet aty?

8.99. Preambula e **KMVer** zë një vend të posaçëm sa i përket promovimit të barazisë së popujve që jetojnë në këtë vend fqinjë me Kosovën. Me **KMVer** të vitit 1991, ka qenë e sforcuar ideja e **Maqedonisë së Veriut** si shtet i kombit maqedon. Aty përmendej, inter alia, "fakti historik se Maqedonia është

konstituuar si shtet nacional i popullit maqedonas në të cilin sigurohet barazia e plotë qytetare dhe bashkëjetesa e përhershme e popullit maqedonas me shqiptarët, turqit, vllahët, romët dhe kombësitë e tjera që jetojnë në Republikën e Maqedonisë". Me amendamentin IV të datës 16 nëntor 2001, Preambula është ndryshuar në tërësi. Tani ajo fillon më një qasje tjetër. Çfarë thotë tani Preambula e **KMVer**?

8.100. Në tekstin fillestar të **KMVer** të vitit 1991, gjendja e pakicave kombëtare dhe pakicave të tjera në Maqedoninë e Veriut ka qenë i e tillë që ka lënë nën hije popujt joshumicë, duke përdorur sllavo-maqedonasit si parametër matës të sasisë dhe cilësisë së lirive dhe të drejtave të pakicave kombëtare dhe pakicave të tjera në këtë vend. Tani si është gjendja në KMVer?

8.101. Të drejtat e posaçme të pakicave në KMZi janë përmbledhur në dy vende. Diskutoni!

9. Lexim shtesë

- Antonio Azara, "Diritti dell' homo". *Novissimo Digesto Italiano* (diretto da Antonio Azara e Ernesto Eula) Vol. V (Vnione Tipografico: Torino, 1968)
- Denar Biba, *Të drejtat e njeriut dhe konstitucionalizmi* (UET Press: Tiranë, 2021)
- Enver Hasani, "Two Chapters on Human Rights and Fundamental Freedoms in the Constitution of Kosovo". *Mediterranean Journal of Human Rights*. Volume 19 Issue 3 (2014)
- Enver Hasani, "Grundrechte im Kosovo". Në Detlen Marten und Hans – Jurgen Papier (eds.), *Handbuch der Grundrechte in Deutchland und Europa. Band IX Grundrechte in Osmittel und Osteuropa* (C. F. Muller: Heidelberg, 2016)
- Enver Hasani, "The Effect and Impact of International Treaties/Conventions on Human Rights Into National Constitutional Systems: The Case of Kosovo". Në Luca Mezzetti (ed.), *International Constitutional Law* (G. Giappichelli Editore: Torino, 2014)
- Florent Muqaj, Përparim Gruda, Constitutional and Legal Dilemmas for Establishing the Association of Kosovo Serb Majority Municipalities, Lex localis - Journal of Local Self-Government, Vol 18 No 3 (2020)
- Giuseppe Ferrari, "Guarentigie costituzionali". *Novissimo Digesto Italiano* (diretto da Antonio Azara e Ernesto Eula) Vol. VIII (Vnione Tipografico: Torino, 1968)
- Hajrullah Hajdari, *Pozita kushtetuese-juridike dhe politike e shqiptarëve në Mal të Zi nga viti 1945-1990* (Art Club: Ulqin, 2021)
- Ivica Crnić, *Ustav Republike Hrvatske u praksi: snapomenama, opsežnom sudskom praksom, literaturom i abecednim kazalom pojmova* (Organizator: Zagreb, 2018)
- J. J. Chevallier, Y. Guchet, *Veprat e mëdha politike. Nga Makiavelli deri në ditët tona* (LIRA: Tiranë, 2001)
- Michael Curtis (ed.), *The Great Political Theories. Volume 1. A Comprehensive Selection of the Crucial Ideas in Political Philosophy from the Greeks to the Enlightement* (HarperPerennial: New York, NY, 1981)
- Michael Curtis (ed.), *The Great Political Theories. Volume2. A Comprehensive Selection of the Crucial Ideas in Political Philosophy from the French Revolution to Modern Times* (HarperPerennial: New York, NY, 1981)
- Paolo Biscaretti di Ruffia, "Diritti e doveri dei citadini". *Novissimo Digesto Italiano* (diretto da Antonio Azara e Ernesto Eula) Vol. V (Vnione Tipografico: Torino, 1968)
- Richard Tarnas, *The Passion of the Western Mind. Understanding the Ideas That Have Shaped Our World* (Rand: New York, 1991)

PJESA E TRETË 3

ZGJEDHJET

1. Përgjithësisht mbi kuptimin e zgjedhjeve dhe historikun e tyre

Zgjedhjet mund të konsiderohen si një urë që lidh dy lëmi themelore të së drejtës kushtetuese: të drejtat e njeriut dhe organizimin e pushtetit. E drejta e qytetarëve përmes zgjedhjeve të përzgjedhin përfaqësuesit e tyre për organet e pushtetit është e drejtë themelore kushtetuese. Për nga natyra, kjo e drejtë është një drejtë politike, sepse qytetarët zgjedhin organet politike të pushtetit. Me realizimin e të drejtave zgjedhore, pra, vjen deri te zgjedhja e organeve të pushtetit dhe lidhja në mes të dy lëmive themelore të së drejtës kushtetuese-të drejtave të njeriut dhe organizimit të pushtetit "Vota është më e rënd se plumbi", e ka thënë diku **Abraham Linkolni** (Abraham Linkoln: 1809-1865), sepse me plumb vret një njeri, me votë vret ardhmërinë e atyre që akoma nuk kanë lindur.

Nga zgjedhjet rrjedh pushteti ligjvënës, në shumë vende edhe presidenti, kurse shumë rrallë edhe kryetari i qeverisë (shefi i ekzekutivit). Përveç kësaj, zgjedhjet mbahen edhe për organet përfaqësuese të njësive federale, regjioneve (krahinave) dhe të vetëqeverisjes lokale. Janë përjashtim zgjedhjet për organet përfaqësuese të bashkësive politike supranacionale, siç është rasti me **Parlamentin e BE-së**: Parlamenti Evropian është i vetmi organ i BE-së që zgjedhet drejtpërsëdrejti.

Zgjedhjet janë një domosdo në shoqëritë demokratike. Për shkak të përhapjes së tyre të madhe, mbase edhe mund të cilësohen si një dukuri e përgjithshme shoqërore. Në shumë shtete, megjithatë, nuk mbahen zgjedhjet si mënyrë e përzgjedhjes së organeve të pushtetit, siç është rasti me disa monarki në vendet e **Lindjes së Mesme** dhe me disa vende republikane atje që mbajnë zgjedhje fiktive sa për të përligjësuar sundimet e tyre despotike (Irani, Siria, dikur Iraku etj). Si farsë, zgjedhjet konsiderohen edhe në Kinë dhe Kore të Veriut, por edhe në vendet e Azisë Qendrore dhe Federatën Ruse. Sidoqoftë, për shkak të përhapjes së tyre të madhe, vendet demokratike mund të bazohen në demokraci të drejtpërdrejtë, gjysmë të drejtpërdrejtë dhe përfaqësuese.

Demokracia e drejtpërdrejtë nënkupton që zbatimin e plotë të idesë së demokracisë si sundim i drejtpërdrejtë i popullit dhe sot është shumë e rrallë, thuajse nuk ekziston. Mbledhja e anëtarëve të bashkësisë politike në tubimet publike ku vendoset në mënyrë kolektive për punët publike, aktualisht i takon historisë. Forma më e njohur e kësaj demokracie ka qenë **eklezia greke** në Athinën e vjetër, në shekujt V dhe IV p.e.s., e përbërë nga qytetarët e lirë.[1] As ardhmëria e demokracisë së drejtpërdrejtë, në të cilën të gjithë qytetarët vendosin, nuk duket të jetë e ndritur. Për më tepër, mund të thuhet se rikthimi i demokracisë së drejtpërdrejtë si mënyrë e marrjes së vendimeve publike përbën një utopi në vete. Për këtë ekzistojnë shumë arsye: numri i madh i atyre që i përkasin shtetit (populli i shtetit-shtetasit), domosdoja e pasjes së dijes profesionale për vendosje, nevoja për marrjen e vendimeve pandërprerë etj. Kjo bën që sot demokracia e drejtpërdrejtë të realizohet vetëm në bashkësitë e imëta politike, të cilat ruajnë traditën e vendosjes

[1] Cf. më shumë për në Mogens Herman Hansen, *The Athenian Ecclesia: A Collection of Articles 1976-1983*, Volume I (Museum Tusculanum Press: Copenhagen, 1983); Mogens Herman Hansen, *The Athenian Ecclesia: A Collection of Articles 1983-1989*, Volume II (Museum Tusculanum Press: Copenhagen, 1989).

së përbashkët. Të tilla janë, ta zëmë, kantonet më të vogla zvicerane **Apencel** (Appenzell) dhe **Glarus** (Glarus).[2]

Në kundërshtim me demokracinë e drejtpërdrejtë, në **demokracinë përfaqësuese** vendimet i marrin përfaqësuesit e qytetarëve, të zgjedhur në zgjedhje, ose ata të cilët vetë përfaqësuesit i kanë mandatuar. Në grupin e parë hyjnë deputetët, kurse në të dytën ministrat dhe eprorët tjerë qeveritarë dhe funksionarët tjerë publik. Nëse nisemi nga fiksioni juridik se shteti bazohet në kontratë shoqërore, demokracia e tërthortë në raport me demokracinë e drejtpërdrejtë është një formë e tjetërsimit të pushtetit sovran nga ana e bartësit të tij autentik – popullit apo qytetarit. Në këtë kuptim kanë qenë dhe janë përsiatjet filozofike dhe teorike që, përmes instituteve të caktuara, mëtojnë zbutjen e shkallës dhe intensitetit të demokracisë së tërthortë, siç janë:

- mandati imperativ (votuesi i jep urdhër deputetit);
- revokimi (tërheqja) i bartësit të funksionit publik;
- mandati i kufizuar në kohë;
- sistemi zgjedhor mazhoritar;
- peticioni;
- iniciativa popullore; dhe
- referendumi/plebishiti.

1.1. Historiku

Zgjedhjet janë një dukuri shumë e vjetër shoqërore. Ato i hasim në një formë të caktuar arkaike edhe në shtetet e vjetra, siç janë, ta zëmë, Greqia dhe Roma. Kështu, ta zëmë, në kohët antike, në **Athinë**, ka qenë karakteristike zgjedhja me short e këshillit (që përbëhej nga 500 anëtarë) dhe gjyqtarëve porotë (që zgjidhnin shumicën e mosmarrëveshjeve të qytetarëve). Me short janë përzgjedhur edhe funksionarët tjerë publikë, me përjashtim të ushtarakëve, gjeneralëve dhe strategëve.[3] U mor vesh, këto forma të përzgjedhjeve të zyrtarëve publikë nuk mund të jenë të krahasueshëm me të drejtën bashkëkohore zgjedhore dhe standardet e saj: doktrina mbi të cilën janë bazuar përzgjedhjet e kohës së vjetër nuk ka pasur të bëjë me ndonjë variant të sistemit mazhoritar, ku e drejta e shumicës mbizotëron ndaj të drejtës së pakicës. Kthesa në këtë drejtim ka ndodhur vetëm shekuj më vonë, konkretisht në shek. XVII, me doktrinën e **Xhon Llokut** (John Locke: 1637-1704), i cili në debatet e tij mbi të drejtën kushtetuese e futi doktrinën mbi të drejtën e shumicës. **Lloku** ka propozuar futjen në sistemin kushtetues të parimit të së drejtës së shumicës, me qëllim të kultivimit dhe zbatimit të këtij parimi në mënyrë institucionale.[4] Deri atëherë, organet e pushtetit janë zgjedhur bazuar në të drejtën zakonore, zakonisht me deklarim hapur në publik të pjesëtarëve meshkuj të moshës madhore të një vendbanimi ose një krahine të caktuar.

---

[2] Cf. më shumë në Alexander H. Trechsel and Hanspeter Kriesi, "Switzerland: the referendum and initiative as a centrepiece of the political system". Në Pier Vincenzo Uleri & Michael Gallagher (eds.), *The Referendum Experience in Europe*. 6th Edition (Palgrave Macmillan; Basingstoke, 1996), fq. 185-208; Hans-Peter Schaub, "Maximising Direct Democracy by Popular Assemblies or by Ballot Votes? *Swiss Political Science Review* Vol. 18 Issue (September 2012), fq. 305-331.

[3] Cf. më shumë për këtë në Richard G. Mulgan, "Lot as a Democratic Device of Selection". *The Review of Politics* Vol. 46, No. 4 (October 1984), fq. 539-560.

[4] Në paragrafët 95-99 të kapitullit të tetë ("Mbi filet e shoqërive politike "), Xhon Loku e bën të qartë se ekziston nevoja për një mekanizëm që është rezultat i zgjedhjes sociale dhe që detyron krejt anëtarët e shoqërisë civile. Ky mekanizëm krijohet me kontratë shoqërore, për të cilën kanë dhënë pëlqimin me vullnet për të bartur disa prerogative individuale që individët i kanë në gjendjen natyrore. Këtë mekanizëm individët e krijojnë për të ruajtur jetën, pronën dhe lirinë e tyre. Cf. John Locke, *Second Treatise of Government and A Letter Concerning Toleration* (B. Blackwell: Oxford, 1948); Cf. edhe Willimoore Kendall, *John Locke and the Doctrine of Majority-Rule* (University of Illinois Press: Urbana, Illinois, 1959); Jacqueline Stevens, "The Reasonableness of John Locke's Majority: *Property Rights, Consent*, and Resistance in the Second Treatise". Political Theory Vol. 24 No. 3 (August 1996), fq. 423-463.

Procedurat zgjedhore që janë realizuar në **komunat mesjetare** kanë rrjedhur nga **rendet fetare**, nga priftërinjtë nëpër manastiret e tyre dhe kështjella, të cilët është dashur t'i zgjedhin eprorët e tyre. Pasi që nuk kanë pasur mundësi të zbatojnë rregullin e rendit të trashëgimisë, as parimin e forcës, atëherë është dashur të bëjnë zgjedhjen e tyre përmes votës. Shefi absolut i Kishës, **Papa**, është zgjedhur në mënyrë të fshehtë dhe sipas rregullave të shumicës, jo sipas të drejtës mazhoritare, kurse vetë zgjedhja çdo herë është dashur të jetë njëzëri: zgjedhësit e padisiplinuar (padëgjueshëm) kanë përjetuar përbuzjen por edhe rrahjen. Kjo nuk do të thotë se zgjedhja e tij ka nënkuptuar edhe përfaqësim, sepse Papa nuk ka përfaqësuar dhe nuk përfaqëson as sot e kësaj dite kardinalët që e votojnë atë.[5] Kjo nënkupton se nevojitet **zgjedhja** dhe **përfaqësimi**, dy komponente që vetëm më vonë në sistemet kushtetuese të vendeve demokratike do të gjejnë rrugën e tyre, me fillim nga revolucionet e fundshekullit XVIII.

Përqafimi i zgjedhjeve si shprehje periodike e vullnetit politik dhe bartjes së sovranitetit, i takon kohës së re. Prejardhja e zgjedhjeve të botës bashkëkohore gjendet në lindjen graduale të qeverisjes përfaqësuese në **Evropë** dhe **Amerikën e Veriut**, me fillim nga shek. XVII. Në shekullin XIX, zgjedhjet bëhen institucion përmes së cilit konstituohet bashkësia politike, fillimisht në **SHBA** e më pas në shtetet e **Evropës perëndimore**. U mor vesh, edhe para konstitucionalizmit të shteteve moderne dhe institucionit të zgjedhjeve si mekanizmit themelor të tyre, kanë ekzistuar organet e pushtetit shtetëror. Mirëpo, qeveritë janë konsideruar si pjesë e natyrshme e rendit të dhënë. Ato nuk janë zgjedhur, siç nuk zgjidhen: klima, toka dhe sëmundja, siç e ka thënë konstitucionalisti e politologu francez **Dyverzhe (**Maurice Duverger: 1917-2014). Disa cilësi të së drejtës për votë janë ndërtuar vetëm në shek. XX, në ndërkohë që shekulli pararendës ngeli i dominuar nga monarkitë.[6] Në shekullin e kaluar vjen deri te krijimi i botëkuptimit mbi vlerën e njëjtë të secilës votë individuale, bazuar në postulatin përgjithësisht të përqafuar "një njeri – një votë"; vota konsiderohet e patjetërsueshme dhe e drejtpërdrejtë – çdo kush personalisht zgjedh anëtarët e organit përfaqësues, jo delegatë apo ndërmjetës, të cilët më pastaj zgjedhin përfaqësuesit e tyre; vota konsiderohet e drejtë e përgjithshme – të drejtën e saj e kanë të gjithë qytetarët nën kushte të njëjta, në të cilat zakonisht hyn shtetësia, mosha madhore, aftësia e veprimit; votimi është i fshehtë, në mënyrë që të sigurohet liria e votuesit pa asnjë pasojë për të nëse ia ka dhënë votën atyre që kanë humbur.

E drejta e zgjedhjeve në kohët e sotme zhvillohet në drejtim të **globalizimit** dhe **ndërkombëtarizimit** të saj. Kjo nënkupton se zgjedhjet janë gati një dukuri universale në shtetet e sotme. Ato nuk ekzistojnë fare vetëm në disa shtete, siç janë, ta zëmë, **Vatikani**, **Arabia Saudite** (zgjedhjet e para lokale në këtë vend janë mbajtur për herë të parë në vitin 2015), **Katari**, **Brunei**, **Saharaja Perëndimore** etj. Aktualisht ekzistojnë standarde ndërkombëtare për fitimin, realizimin dhe mbrojtjen e të drejtës së zgjedhore për zgjedhje të lira, gjë që flet për ndërkombëtarizimin e saj.

1.2. Konceptet themelore

Lidhur me zgjedhjet, duhet të dallohen konceptet themelore, siç janë:

- **e drejta zgjedhore**;
- **e drejta e zgjedhjes**; dhe
- **e drejta e votës**.

---

5 Giovanni Sartori, *The Theory of Democracy Revisted.* Part One (Chatham House Publishers, Inc.: New Jersey, 1987), fq. 30.

6 Duke folur për **Evropën**, studiues të ndryshëm kanë vërejtur se shek. XX ka qenë i dominuar nga monarkitë, me Francën dhe Zvicrën si dy shtete jomonarkike të rëndësishme dhe si përjashtim nga kjo rregull. Monarkia gjerësisht është marrë si e mirëqenë në fund të shekullit XIX e deri në fund të Luftës së Parë Botërore, njëjtë si zgjedhjet e përgjithshme sot. Cf. John Morris Roberts, *A General History of Europe: 1880-1945*. Sixth impression (Longman Group Ltd.: London and New York, 1976), fq. 62-70.

Këto koncepte kanë kuptime të ndryshme në vende të ndryshme, por shpesh përdoren edhe si sinonime që përshkruajnë të drejtën për të votuar në zgjedhje.

E drejta zgjedhore përfshinë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që kanë pjesëmarrësit në zgjedhje, materien e tërësishme juridike që ka të bëj me zgjedhjet. E drejta zgjedhore është degë e varur e sistemit juridik dhe disiplinë shkencore, pjesë e veçantë e të drejtës kushtetuese që në mënyrë të thelluar hulumton zgjedhjet dhe normon në mënyrë të detajuar të njëjtat.

Baza juridike e ndërtimit të organit përfaqësues, parlamentit, janë **të drejtat e zgjedhjes të qytetarëve**. Këto janë gurthemel i demokracisë dhe qeverisjes popullore, sepse përmes tyre qytetarët marrin pjesë në drejtimin e punëve publike. Një aspekt i të drejtave të zgjedhjes është **zotësia zgjedhore** – **e drejta aktive zgjedhore**, e cila përfshinë tërësinë e të drejtave (më rrallë detyrimeve) të qytetarëve lidhur me zgjedhjen e përfaqësuesve politikë. Ana tjetër e të drejtave të zgjedhjes është **zotësia përfaqësuese** – **e drejta pasive zgjedhore**. Kjo e drejtë paraqet tërësinë e të drejtave dhe detyrimeve lidhur me të drejtën e qytetarëve për të qenë të zgjedhur, përkatësisht të drejtën që të bëhen kandidatë në zgjedhje. Kushtet për arritjen e të drejtës aktive dhe pasive zgjedhore mund të jenë të njëjta (shtetësia, mosha madhore, zotësia veprimit) apo jo të njëjta – kur kushtet për fitimin e të drejtave zgjedhore janë më të rrepta dhe më të shumta.

Nga të tria, **e drejta e votës** është koncepti më i ngushtë dhe paraqet realizimin e të drejtave zgjedhore. Kjo e drejtë nënkupton të drejtat dhe detyrimet e votuesve lidhur me vetë votimin. Votimi duhet të jetë, mbi të gjitha, i lirë, për çka duhet të sigurohen të gjitha kushtet teknike dhe standardet juridike për vënien në jetë të këtij segmenti të së drejtës zgjedhore.

Si të gjitha dukuritë shoqërore, zgjedhjet kanë evoluar dhe janë zhvilluar përgjatë historisë. Në mënyrë graduale është zgjeruar baza votuese, çdo herë e më shumë kategoritë e caktuara të qytetarëve kanë fituar të drejtat zgjedhore. Sot ato janë të drejta të përgjithshme – çdo kush ka një votë që ka vlerë të njëjtë, votohet drejtpërdrejt dhe me votim të fshehtë. Si një dukuri e kohës së re, në të drejtën zgjedhore çdo herë e më shumë zbatohen masat e veprimit afirmativ ndaj grupeve të caktuara shoqërore, në mënyrë që të arrihet realizimi sa më i madh i të drejtave të tyre të zgjedhjes dhe të drejtës së përfaqësimit.

2. Burimet e të drejtës zgjedhore

Rregullat juridike mbi zgjedhjet gjenden në aktet ndërkombëtare dhe vendore. Globalizimi dhe ndërkombëtarizimi i të drejtës ka bërë që të krijohen burime të rëndësishme të së drejtës zgjedhore. Në **Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut** (DUDNJ) i garantohet çdokujt "e drejta për të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike të shtetit të vet, drejtpërdrejt ose përmes përfaqësuesve të zgjedhur lirisht" (neni 21). Një e drejtë e njëjtë gjendet edhe në **Paktin për të Drejtat Civile dhe Politike** (PDCP), i cili thekson se "vullneti i popullit është themel i pushtetit shtetëror, i cili shprehet në zgjedhje të lira dhe të kohëpaskohshme, që realizohen përmes të drejtës së përgjithshme dhe të barabartë për votë, votim të fshehtë ose procedurë përkatëse me të cilën sigurohet liria e votimit" (neni 21). Në Protokollin I të **Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut** (KEDNJ) garantohet e drejta për zgjedhje të lira për organin ligjvënës, që mbahen në periudha të arsyeshme kohore, me votim të fshehtë që mundëson shprehjen e vullnetit të lirë të popullit (neni 3). Me Protokollin I, pra, garantohet fshehtësia e votimit me qëllim që të mundësohet shprehja e lirë e vullnetit, si dhe e drejta e përgjithshme dhe e barabartë e të drejtës për votë pa kufizime të arsyeshme (të pavend). Kjo do të thotë se e drejta për votim, megjithatë, nuk është një e drejtë absolute dhe, si e tillë, mund të kufizohet apo privohet, por arsyet për një masë të tillë nuk guxojnë të jenë të paarsyeshme (pa vend). Nëse kufizimi apo privimi i kësaj të drejte është i arsyeshëm përcaktohet nga shtetet palë në **KEDNJ**, gjë që e bën këtë standard mjaft të papërcaktuar. Edhe në një nivel tjetër evropian, në një dokument të ish-KSBE (tani OSBE), miratuar në **Kopenhagë** në vitin 1990, është vërtetuar e drejta për votë për qytetarët madhor, fshehtësia e votimit dhe të drejtat tjera (neni 7).

Burimet e brendshme të së drejtës zgjedhore përpunojnë dispozitat e marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, me fillim nga kushtetuta e deri te aktet nënligjore. Kushtetutat përmbajnë normat më të rëndësishme të së drejtës zgjedhore që kanë të bëjnë, **inter alia**, me sa vijon:

- shpalljen e zgjedhjeve;
- të drejtën aktive dhe pasive zgjedhore;
- numrin e anëtarëve të parlamentit;
- sistemin zgjedhor;
- organet që zbatojnë zgjedhjet;
- njësitë zgjedhore, etj.

Këto tema, si dhe ato që kanë të bëjnë me procedurat zgjedhore, i përpunojnë më tutje ligjet mbi zgjedhjet. Në ligje të tilla gjenden dispozitat e detajuara lidhur me realizimin e të drejtave zgjedhore, siç janë:

- votimi dhe kandidimi
- sistemi zgjedhor dhe shpërndarja e mandateve;
- numri dhe kufijtë e njësive zgjedhore;
- përbërja dhe kompetencat e komisionit zgjedhor ose trupit tjetër të barasvlershëm me të;
- mbrojtja e të drejtave zgjedhore; dhe
- listat zgjedhore.

Me **akte nënligjore** normohen aspektet procedurale dhe teknike të realizimit të zgjedhjeve, gjithashtu të domosdoshme për zbatimin e ligjshëm të zgjedhjeve të lira e të drejta. Në këtë grup të akteve hyjnë:

- udhëzimet;
- rregulloret; dhe
- vendimet.

Këto akte i nxjerrin organet e ngarkuara me zbatim dhe përcjellje të zgjedhjeve. Me to, në mënyrë të detajuar rregullohet vetë mënyra e votimit, pamja e vendvotimit, përbërja e trupës në vendvotim, puna (mënyra e punës) me listat votuese dhe materialin tjetër zgjedhor, mënyra dhe koha e shpalljes së rezultateve dhe çështje të tjera të fushatës zgjedhore. Këto rregulla shpesh ndryshojnë dhe plotësohen, kryesisht para çdo palë zgjedhjeve.

Normativa apo rregullat zgjedhore mund të grupohen edhe në aspektin e përmbajtjes, përkatësisht sipas objektit që rregullojnë. Rregullat e **të drejtës zgjedhore materiale** gjenden në kushtetutë dhe ligje dhe kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve në zgjedhje, statusin e tyre juridik. Më konkretisht, ato janë dispozita që normojnë të drejtën aktive dhe pasive zgjedhore, të drejtën e kandidimit të të tjerëve dhe të drejtën e kandidimit të vetvetes, të drejtën e votës, të drejtën për informim mbi zgjedhjet, të drejtën e vëzhgimit dhe kontrollimit të zgjedhjeve, të drejtën e mbrojtjes së të drejtave zgjedhore. Veprat penale dhe kundërvajtjet lidhur me zgjedhjet mund të jenë pjesë e të drejtës zgjedhore materiale, apo të normohen me ligjin penal dhe ligjin për kundërvajtje. Normat me të cilat rregullohet procedura zgjedhore, që nga shpallja e zgjedhjeve, votimi, e deri te publikimi i rezultateve përfundimtare, mund të cilësohen si **e drejtë zgjedhore procedurale**. Këto çështje janë objekt i normimit ligjor dhe nënligjor. Në të drejtën zgjedhore procedurale mund të futet edhe procedura e regjistrimit në listën zgjedhore. Rregullat mbi bazën e të cilave zhvillohen zgjedhjet, në fakt, normojnë aktivitetet para, gjatë dhe pas votimit. Në këto aktivitete bëjnë pjesë kandidimi, fushata zgjedhore, shtypja dhe dërgimi i materialit zgjedhor, votimi, vëzhgimi dhe kontrolli i zgjedhjeve, vërtetimi i rezultateve të zgjedhjeve, zgjidhja e kontesteve zgjedhore dhe, së fundi, ruajtja e materialit zgjedhor.

Si **rregulla juridike shtesë të natyrës procedurale** konsiderohen edhe dispozitat e degëve të tjera të së drejtës: rregullat e procedurës së përgjithshme administrative gjejnë zbatim në punën e komisioneve zgjedhore; rregullat e të drejtës penale dhe të drejtës për kundërvajtje zbatohen nëse gjatë zgjedhjeve vjen deri ndërmarrja e veprimeve që përbëjnë vepër të dënueshme penale, përkatësisht kundërvajtje; nëse mund të ushtrohet mjeti juridik në gjykatën kushtetuese, atëherë vjen deri te zbatimi i rregullave që normojnë procedurat pranë gjykatës kushtetuese.

E drejta zgjedhore përmban edhe rregulla që për nga natyra e tyre i takojnë **gjeometrisë (gjeografisë) zgjedhore**, **matematikës zgjedhore** dhe **teknikës zgjedhore.** Gjeometria zgjedhore është pjesë e të drejtës zgjedhore që përcakton kriteret për formimin e njësive zgjedhore (numri banorëve, numri votuesve), dhe kufijtë e tyre. Kufijtë e njësive zgjedhore, me ndryshim ose mosndryshim për një kohë të gjatë, mund të shndërrohen në mjet favorizimi të kandidatëve të caktuar, gjë që njihet si **xherimandering** (angl: gerymandering). Rregullat e **matematikës zgjedhore** janë metoda zgjedhore për përllogaritjen e votave dhe kthimin e tyre në mandate në sistemin proporcional dhe të përzier zgjedhor. Këtu qëllimi është që, përmes kësaj metode, vullneti politik i votuesit të paraqitet në numër të mandateve në parlament në një mënyrë sa më besnike dhe proporcionalisht. Në sistemin zgjedhor mazhoritar, **matematika zgjedhore** ka të bëj me numërimin e thjeshtë të numrave, Përveç rasteve kur zbatohen metodat përparimtare, siç janë **votimi alternativ** dhe **votimi kumulativ**. Me rregullat e **teknikës zgjedhore** normohet në mënyrë të detajuar rrjedha e procedurës zgjedhore dhe veprimet zgjedhore: pamja dhe mënyra e shfrytëzimit të listës së votimit, pamja e kutisë së votimit, përdorimi i spërkatësit si mjet për identifikim të votuesit, rruga e materialit zgjedhor para dhe pas votimit, përmbajtja e procesverbalit nga vendvotimi dhe rregulla të tjera të detajuara të domosdoshme për veprim të njëtrajtshëm dhe të ligjshëm të anëtarëve të organit që realizon zgjedhjet.

3. E drejta e zgjedhjes

E drejta e zgjedhjes është e drejtë që del nga zgjedhjet dhe, si e tillë, garantohet me kushtetutë. Realizimi i kësaj të drejte më tutje operacionalizohet me ligje dhe akte nënligjore. Kjo e drejtë gëzon mbrojtje juridike.

Në brendinë e kësaj të drejte përfshihen **e drejta për të zgjedhur** dhe **e drejta për qenë i zgjedhur**, së bashku me një sërë të drejtash tjera që rrjedhin prej tyre. E para njihet si e drejta aktive e zgjedhjes, përkatësisht aftësia/zotësia për të zgjedhur, kurse e dyta njihet si e drejta pasive e zgjedhjes, përkatësisht aftësia/zotësia për të qenë i zgjedhur. Kjo e fundit nganjëherë quhet si e drejta për të kandiduar.

Lidhur me **natyrën juridike** të së drejtës së zgjedhjes ekzistojnë pikëpamje të ndryshme. Ato mund të grupohen në tri grupe. Sipas grupit të parë, e drejta e zgjedhjes është një e drejtë subjektive (individuale) njerëzore, kurse sipas të dytit ajo e drejta e zgjedhjes paraqet funksion publik. Grupi i fundit, ndërkaq, kombinon dy të parat dhe pajton dallimet në mes tyre në formimin e konceptit përfundimtar vetjak. Të shohim pikëpamjet e secilit prej grupeve dhe esencën e tyre.

Si një e drejtë individuale njerëzore, **e drejta e zgjedhjes** rrjedh nga sovranitetit i popullit. Për këtë arsye, në shtetet që bazohen në sovranitetin popullor, qytetarët këtë të drejtë nuk e fitojnë me kushtetutë, as me ligj, sepse këto akte juridike vetëm konstatojnë ekzistimin e saj dhe e marrin si të mirëqenë. Kushtetuta, ligji dhe aktet tjera vetëm konstatojnë ekzistimin e kësaj të drejte, pra nuk janë krijues dhe njohës të saj. Për këtë arsye, sipas kësaj pikëpamjeje, e drejta e zgjedhjes është më e fuqishme se ligji, e gëzojnë të gjithë qytetarët, ka vlerë të njëjtë dhe nuk mund të kufizohet e as të merret. E drejta e zgjedhjes ka lindur nga një pjesë e sovranitetit popullor, të cilin e posedon çdo qytetar dhe me të cilin disponon në mënyrë sovrane. Qytetari të drejtën e zgjedhjes, për rrjedhojë, nuk mund t'ia kaloj dikujt tjetër, pra nuk mund ta tjetërsoj, sepse ajo nuk është një e drejtë nga sfera e të drejtës private, por nga sfera e të drejtës publike, përkundër faktit që nga vullneti i qytetarit varet

nëse kjo e drejtë do të shfrytëzohet ose do të ngelet pa u shfrytëzuar. Për këtë arsye, dalja në zgjedhje është vetëm e drejtë, jo edhe detyrim, që nënkupton edhe të drejtën për të mos dalë në zgjedhje, për të mos votuar.

Pikëpamja tjetër mbi natyrën juridike të së **drejtës së zgjedhjes** bazohet në atë se këtu bëhet fjalë për një të drejtë njerëzore, që njëkohësisht ka edhe karakter të së drejtës politike, që normohet me kushtetutë dhe ligj si funksion publik. Realizimi i të drejtës së zgjedhjes, në thelb, sipas kësaj pikëpamje, përbën ushtrim të funksionit publik, përkatësisht ushtrim pushteti, gjë që nënkupton shprehje të vullnetit nacional. Vullnetin e përgjithshëm nacional e krijon kombi, të cilin e përbëjnë të gjithë qytetarët dhe të cilin e karakterizon **sovraniteti nacional**. Për dallim nga sovraniteti popullor, sovraniteti nacional nuk është i pjesëtueshëm (nuk mund të ndahet) në sovranitete individuale të qytetarëve. E drejta e zgjedhjes është funksion publik me të cilën realizohet sovraniteti nacional, kurse qytetarët janë organ i pushtetit shtetëror. Ata, pra qytetarët, kanë detyrim për ushtrim të pushtetit, që nënkupton se e drejta e zgjedhjes përbën një detyrim, moszbatimi i së cilës mund të tërheq pasoja të caktuara. Gjithnjë sipas kësaj pikëpamjeje, shteti ka të drejtë që, paraprakisht, t'i eliminojë personat që nuk mund të shprehin vullnetin e kombit, nuk janë të denjë për një gjë të tillë, që nënkupton se e drejta e zgjedhjes mund të kufizohet.

Sipas pikëpamjes së fundit, natyra e të drejtës së zgjedhjes është e ndërlikuar: ajo është një e drejtë individuale por, njëkohësisht, edhe një funksion publik. Vetë qytetarët vendosin nëse do ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre të zgjedhjes. Mirëpo, nëse vendosin për një gjë të tillë, atëherë ata për një kohë të shkurtër, në momentin e votimit, bëhen funksionarë publikë, përkatësisht organe shtetërore që shprehin vullnetin dhe sovranitetin nacional.

3.1. Kushtet për fitimin e të drejtës aktive zgjedhore dhe cilësitë e saj

E drejta aktive e zgjedhjes fitohet me vetë plotësimin e kushteve juridikisht të përcaktuara, pa pasur nevojë për ndërmarrje të veprimeve të posaçme apo plotësim të kërkesave të caktuara. Që qytetarët të kenë të drejtën aktive zgjedhore, së pari duhet të plotësohen kushtet që kanë të bëjnë me sa vijon:

- **lidhjet e tyre juridike me shtetin;**
- **pjekurinë e tyre jetësore;**
- **shëndetin e tyre mendor;** dhe
- **cilësitë tjera të tyre.**

Të drejtën e zgjedhjes e kanë, sipas rregullit, vetëm shtetasit, jo edhe të huajt dhe personat pa shtetësi (apatridët). Ky kusht nënkupton që mes shtetit dhe shtetasit ekziston një lidhje formale e natyrës juridiko-publike, e cila përkthehet në ekzistimin e një sërë të drejtash dhe detyrimesh, përfshirë të drejtën e zgjedhjes. Mënyra e fitimit të **shtetësisë**, – me **prejardhje** (origjina/afërsia), **lindje në territorin e shtetit** dhe **natyralizim** - këtu nuk ka rëndësi. Me humbjen e shtetësisë, pushon së ekzistuari e drejta e zgjedhjes. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi mund të kenë zotësinë e kufizuar të zgjedhjes, që ka të bëj me zgjedhjen e organeve të pushtetit vendor (lokal).

Krahas shtetësisë kërkohet që qytetarët të kanë **vendbanim** (domicil) në shtetin e vet. Vendbanimi, megjithatë, nuk është kusht për fitimin e të drejtës së zgjedhjes, por kusht për realizimin e saj. Pa vendbanim, zgjedhësi nuk ka të drejt të votojë, nuk ka vendvotim të cilit i takon.

Për fitimin e të drejtës së zgjedhjes, prezumimi i pjekurisë së mjaftueshme jetësore paraqet **mosha madhore**. Mosha madhore në shumicën e shteteve arrihet me moshën 18-vjeçare, diku ky kufi është shtyrë më lartë (ta zëmë: 19 vjeç në Korenë e Jugut, në Japoni 20 vjeç, në Misisipi dhe Kolorado të SHBA-ve 21 etj), apo është ulur (ta zëmë: në Iran 15 vjeç, në Skoci 16 vjeç, në Korenë e Veriut 17

vjeç etj). Rast i veçantë është kur mosha madhore nuk paraqet kusht të mjaftueshëm për arritjen e të drejtës së zgjedhjes (na Austri, ta zëmë, deri në vitin 1922 për fitimin e të drejtës aktive të zgjedhjes është kërkuar arritja e moshës 19-vjeçare, në ndërkohë që mosha madhore ka qenë 18 vjeç).

Zotësia e veprimit paraqet kusht thelbësor për fitimin e të drejtës së zgjedhjes, sepse kjo cilësi vërteton se qytetari mund të shpreh vullnetin e vetë politik. Te ky kusht ekziston supozimi se vetëm personi me zotësi veprimi posedon kapacitetin psikik që të vendos politikisht, në këtë rast të votoj. E kundërta e kësaj, personi që e ka humbur (i është marrë) zotësinë e veprimit, që me veprimet e veta nuk mund të prodhoj pasoja juridike, nuk gëzon as të drejtën e zgjedhjes. Zotësia e plotë e veprimit arrihet me arritjen e moshës madhore, përjashtimisht mund të fitohet edhe më herët. Kthimi i zotësisë së veprimit për shkak se, ta zëmë, personi i sëmurë psikik është shëruar në ndërkohë, nënkupton edhe rikthim i të drejtës së zgjedhjes, u mor vesh, me kusht që janë plotësuar kushtet tjera si më sipër.

Cilësia e parë e të drejtës së zgjedhjes është se kjo është një **e drejtë e përgjithshme**. Kjo nënkupton se e gëzojnë të gjithë qytetarët nën kushtet të njëjta dhe pa asnjë diskriminim. Ky paraqet kusht të domosdoshëm për natyrën demokratike të regjimit, organet e të cilit i kanë zgjedhur qytetarët e barabartë. E drejta e zgjedhjes mund të kufizohet vetëm në bazë të kushteve saktësisht të përcaktuara me kushtetutë e ligj, që lidhen me personin e individit – sëmundja psikike, statusi juridik, heqja dorë nga shtetësia, ose për shkak të kryerjes së veprës penale.

Cilësia e të qenit një **e drejtë e përgjithshme** paraqet një karakteristikë të kohës së re, të cilën e drejta e zgjedhjes nuk e ka pasur në të gjitha kohërat. Në kohën e kushtetutave të para, diku deri kah mesi i shek. XX, **e drejta e zgjedhjes nuk ka qenë e përgjithshme**. Grupe të tëra shoqërore të moshës madhore dhe me zotësi të plotë veprimi **kanë qenë të përjashtuara nga gëzimi i kësaj të drejte**, për shkak të gjendjes së tyre pasurore, vendbanimit, arsimimit, origjinës shoqërore, gjinisë biologjike. Anëtarët e profesioneve të caktuara, kanë qenë gjithashtu të përjashtuar nga gëzimi i të drejtës së zgjedhjes: zyrtarët në administratën shtetërore, pjesëtarët e ushtrisë, shkaku i ndarjes së pushtetit ushtarak nga pushteti civil dhe kështu me radhë.

Kushti i pasurisë apo **censusi material** ka qenë një kusht mjaft i përhapur në të kaluarën. Ky kusht ka nënkuptuar se bartësi i të drejtës së zgjedhjes është dashur të ketë pasuri. Kjo është provuar me dëshminë mbi të drejtën e pronës në patundshmëri, pagimin e tatimit, tatimin e paguar, të ardhurat në të holla apo, ta zëmë, me vetë faktin që bartësi i kësaj të drejte nuk ka qenë në "listën e të varfërve" (kështu ka qenë në shtetin Maine në SHBA). Me fitimin e pasurisë nga një numër gjithnjë e më i madh i qytetarëve është zgjeruar edhe e drejta e zgjedhjes, ashtu që në fund ka ardhur deri te zhdukja e këtij kushti – kushtit të pasurisë. Sot ky kusht nuk ekziston dhe nuk është provuar asnjëherë se njerëzit e kamur mund të zgjedhin përfaqësues më cilësorë se sa njerëzit e skamur.

Kushti i vendbanimit apo **censusi i domicilit** nënkupton se për fitimin e të drejtës së zgjedhjes qytetari duhet të ketë qenë i vendosur me banim një kohë të caktuar në shtetin ku synon ta gëzoj këtë të drejtë. Ky kusht ekziston akoma në disa shtete, kryesisht për të drejtën pasive zgjedhore dhe shprehet në vitet e banimit (më së shumti deri në 14 vjet, në SHBA). Arsyeja e mbajtjes së këtij kushti qëndron në kërkesën për lidhjen sa më të fortë të individit me shtetin.

Kushti i arsimimit ose **censusi arsimor** ka pasur të bëj me kërkimin e një shkalle të caktuar të arsimimit në mënyrë që të fitohet e drejta e zgjedhjes. Me zbatimin e kërkesës së këtij kushti ka ardhur deri te eliminimi nga e drejta e zgjedhjes së individëve analfabetë. Si dëshmi për plotësimin e këtij kushti ka shërbyer nënshkrimi i qytetarit. Në këtë mënyrë, njerëzit me ngjyrë në SHBA, edhe pas fitimit të të drejtave civile në vitin 1870, kanë qenë praktikisht të përjashtuar nga e drejta e zgjedhjes, sepse në masë të madhe nuk kanë ditur shkrim dhe lexim; si skllevër të deridjeshëm

kanë ngelur analfabetë për shkak se iu qe mohuar e drejta për arsimim. Sot kushti i arsimimit nuk ekziston, kurse zgjedhësve analfabetë iu mundësohet realizimi i të drejtës së tyre të zgjedhjes me ndihmën e personit tjetër - interpretuesit.

Origjina, raca (ngjyra e lëkurës), gjithashtu kanë qenë pengesë për fitimin e të drejtës së zgjedhjes. Kështu, ta zëmë, njerëzit me ngjyrë në SHBA, popujt autokton në **Australi** (deri në vitin 1967) dhe në **Afrikën e Jugut** (deri në vitin 1990), për shkak të përkatësisë së tyre racore nuk kanë gëzuar të drejtën e zgjedhjes, por as të drejta të tjera politike. Përkatësia e bashkësisë religjioze ka qenë, por më rrallë, një pengesë për gëzimin e të drejtës së zgjedhjes (**hebrenjtë** në disa vende evropiane gjatë shek. XIX;[7] **katolikët**, **hebrenjtë**, **kuakerët** dhe **ateistët** në disa prej ish-kolonive britanike të **Amerikës së Veriut**, para dhe pas pavarësisë së tyre).[8]

Si pengesë për realizimin e të drejtës së zgjedhjes më së gjati ka qëndruar **gjinia.** E drejta e zgjedhjes ka lindur dhe është zhvilluar si e drejtë e meshkujve. Gratë vetëm në shekullin XX kanë nisur të fitojnë në mënyrë sporadike të drejtën e zgjedhjes. E drejta e zgjedhjes për **gratë** së pari në vendet skandinave në nivel qendror, në zgjedhjet vendore (lokale) në **Australi** e **Spanjë**, dhe më pastaj në shumicën e vendeve pas **Luftës së Dytë Botërore**. Kjo pengesë edhe sot ekziston në një numër të vendeve muslimane të **Lindjes së Afërt**, në ndërkohë që ekziston një tendencë e fuqishme e shteteve që përmes masave afirmative të ndikohet në pranimin gjithnjë e më të madh të kësaj të drejte për gratë, veçanërisht të së drejtës së tyre pasive të zgjedhjes.

E drejta aktive e zgjedhjes është **e njëjtë** (barabartë). Kjo nënkupton që secila votë ka vlerë të njëjtë, përkatësisht që në rezultatin e zgjedhjes, ndikimi i secilës votë është i njëjtë. Kjo shprehet me fjalinë e njohur: një njeri – një votë. Në të kaluarën ka pasur shembuj të shumtë të pabarazisë në gëzimin e të drejtës aktive të zgjedhjes. Sistemi më i njohur i kësaj pabarazie ka qenë ai në të cilin qytetarët e pasur dhe të arsimuar kanë pasur dy e më shumë vota, sistem që është njohur si **votimi plural** dhe ka ekzistuar në Belgjikë në një periudhë të caktuar (nga viti 1839 deri në vit-in1919).[9] Sistemi i **votës plurale**, ndryshe i njohur si **epistokraci**, përkatësisht qeverisje e njerëzve të dijshëm, ka gjetur përkrahës edhe në shekullin XXI, duke marrë si shkas zhvillimet politike në **SHBA** dhe në disa vende të **Amerikës Latine**.[10] Në **Britaninë e Madhe** ka mundur të votohet deri

---

7 Cf. më shumë në William I. Burstein and Ryan D. King, "Anti-Semitism in Europe Before the Holocaust" *International Political Science Review* Vol 25 No. 1 (2004), fq. 35–53; Manfred Gerstenfeld, "The Deep Roots of Anti-Semitism in European Society". *Jewish Political Studies Review* Vol. 17, No. 1/2 (Spring 2005), fq. 3-46.

8 Cf. më shumë në Chilton Williamson, *American Suffrage: From Property to Democracy, 1760-1860* (Princeton University Press: Princeton, 1960).

9 Pararendës teorik i votimit plural është **Xhon Stuart Mill** (John Stuart Mill: 1806 – 1873), i cili ka provuar të fus në vendimmarrje sa më shumë ekspertë, përkatësisht njerëz të specializuar dhe edukuar për fusha të caktuara. U muar vesh, kjo shkon në dëm të demokracisë, të cilën vetë XH. S. Mill e ka promovuar. Konteksti historik i këtij propozimi, megjithatë, ka pasur jehonë dhe kuptim sepse ka synuar balancimin e votës së lirë me interesin e përgjithshëm, duke synuar involvimin sa më të madh në vendimmarrje për interes publik të shtresave të edukuara dhe të ditura të shoqërisë. Cf. më shumë për këtë në Elvio Baccarini and Viktor Ivankovic, "Mill's case for plural voting and the need for balanced public decisions". *Prolegomena* Vol. 14 No. 2 (2015), fq. 137-156; Dale E. Miller, "The Place of Plural Voting in Mill's Conception of Representative Government". *The Review of Politics* Vo. 77 No. 3 (2015) fq. 399-423.

10 Cf. Thomas Mulligan, "Plural Voting for the Twenty-First Century". *The Philosophical Quarterly* Vol. 68 Issue 271 (April 2018) fq. 286-306 (zhvillimet e fundit, sipas këtij autori, kanë vënë në dyshim mençurinë e vendimmarrjes demokratike: **Brexit**-i, refuzimi i paqes më grupin paramilitar në **Kolumbi**, i njohur si **FARC** si dhe zgjedhja e **Donald Trump** për president të SHBA-ve në vitin 2017 janë marrë si shkas për hulumtim të rrugëve alternative ndaj demokracisë; në këtë shkrim, autori mbron **sistemin epistokratik të qeverisjes**, i cili, sipas tij, marrë parasysh njohuritë teorike dhe empirike, duhet të jetë shumë më i mirë se sistemi demokratik një njeri një votë; për këtë arsye, ky autor propozon që pesha e votës të bazohet jo në logjikën demokratike, por në kompetencën e votues, në dijen e tyre, dhe për këtë propozon një standard objektiv të matjes së dijes dhe njohurive të votues, të cilat ky i quan kompetencë e votuesit, pa pasur nevojë të prodhohet një krahasim në mes të votuesve individual. Krejt ky artikull mëton vënien në jetë të idesë fillestare të **Xhon Stuart Millit**.

në vitin 1948, në secilën njësi në të cilën individi ka pasur patundshmëri, gjë që përbën një variant të sistemit të **votës plurale**, por i bazuar në pasurinë e individit. Një sistem tjetër i ngjashëm me këtë është ai i **votimit familjar**: këtu kryefamiljari (**pater familias**) voton në emër të familjes.[11] Ky lloj votimi duhet të dallohet nga votimi që ndikohet nga anëtarët e familjes reciprokisht, përkatësisht nga ngjashmëritë në votime të anëtarëve të familjes, që është krejtësisht legjitime dhe nuk përbën standard jokushtetues që prek në barazinë e të drejtës aktive të zgjedhjes.[12]

Përveç sistemeve si më sipër dhe situatave që iu referohen ato, ekziston pabarazia në realizimin e të drejtës aktive të zgjedhjes edhe për shkaqe faktike. Kjo quhet **pabarazia faktike** dhe lind atëherë kur përmes **gjeometrisë/gjeografisë zgjedhore** caktohen njësi të atilla zgjedhore ku votat në njërën prej tyre kanë peshë më të madhe krahasuar me votat në njësinë tjetër. Kjo situatë ekziston atëherë kur në njësitë zgjedhore me numër afërisht të njëjtë të votuesve zgjidhet numër i ndryshëm i deputetëve: aty ku zgjidhen më shumë deputet, vota ka vlerë më shumë se në njësitë zgjedhore ku zgjidhen me pak; për pasojë, vlera e votës nuk është e njëjtë në dy njësitë zgjedhore, ani se numri i votuesve është afërisht i njëjtë ose krejtësisht i njëjtë.

E drejta e zgjedhjes është **e lirë** atëherë kur lirohet nga çdo presion, nuk i nënshtrohet asnjë presioni me rastin e ushtrimit të saj. Që votuesi të jetë në gjendje të realizoj të drejtën e zgjedhjes në mënyrë të lirë, kusht i domosdoshëm është që vota të jetë **e fshehtë**. Ky kusht për herë të parë është realizuar në **Britaninë e Madhe** në vitin 1872. Sikur votimi të ishte i hapur, atëherë do të ushtrohej presion mbi votuesit, para dhe pas votimit. Kjo do të shkaktonte daljen e ultë në zgjedhje. Votimi i hapur mund të ekzistojë vetëm në një shoqëri ideale. Si i tillë, ai krijon një popull të armiqësuar brenda vetes. Mendimi se drejta e zgjedhjes duhet të realizohet në mënyrë të hapur, arsyetimin teorik e ka gjetur te ideja se ushtrimi i kësaj të drejte është ushtrim i funksionit publik. U mor vesh, kjo ide në praktikë nuk ka mund të gjej përkrahje.

Drejtëpërdrejtshmëria e të drejtës aktive të zgjedhjes përbën një cilësi të rëndësishme dhe nënkupton se përfaqësuesit popullor zgjidhen drejtpërdrejt. Në zgjedhjet e drejtpërdrejta nuk votohet për delegat që më pas zgjedhin anëtarët e parlamentit, por votohet drejtpërdrejt për deputetë të popullit. Kjo cilësi është më e theksuar në sistemin mazhoritar, me njësitë e vogla zgjedhore ku votuesit zgjedhin një përfaqësues, krahasuar me sistemin proporcional zgjedhor me njësi të mëdha zgjedhore ku votohet për listën zgjedhore.

3.2. Kushtet për fitimin dhe realizimin e të drejtës pasive zgjedhore

E drejta pasive e zgjedhjes është emër tjetër për zotësinë për përfaqësim (deputim) dhe shprehet në mundësinë e qytetarit për të marrë pjesë në zgjedhje si kandidat dhe, pas zgjedhjeve, t'i përfaqësojë qytetarët në parlament (deputet i dërguar nga qytetarët me votë për të ushtruar në emër të tyre

[11] Ky sistem, megjithatë, ka ngel vetëm në nivel të idesë. Nuk ka gjetur zbatim në praktikë. Si një ide, së pari ka nisur në **Francë** pas vitit 1848, kur u njoh e drejta e votës për meshkujt e moshës madhore, që ishte 21 vjeç, u përsërit më pas nga disa dijetar francez, përfshirë edhe politikanët francez nën regjimin nazist, por kurrë nuk u zbatua në praktikë. Edhe **Gjermania** në shek. XIX dhe në mes të dy luftërave botërore ka trajtuar shumë idenë e **votimit familjar**. Në dy vendet, ideja bazike ka qenë që kryefamiljari ka detyrë të përkujdeset për familjen dhe, për pasojë, votimi familjar duhet të jetë pjesë e kësaj përkujdesjeje sepse e forcon familjen. Kjo logjikë është provuar më vonë, në vitin 1986, edhe në **SHBA** nga **Paul Demeny**. Për këtë arsye edhe njihet me emrin "Demeny voting". Ky autor ka propozuar votimin për fëmijët dhe anëtarët tjerë të familjes, si kundërpërgjigje ndaj fertilitetit të ulët familjar të kohës. Cf. më shumë në Jenny Gesley, "Family Voting as a Solution to Low Fertility? Experiences from France and Germany". *In Custodia Legis*. *Law Librarians of Congress* (April 19, 2018). Në internet: https://blogs.loc.gov/law/2018/04/family-voting-as-a-solution-to-low-fertility-experiences-from-france-and-germany/ (shikuar më 30 gusht 2022).

[12] Cf. më shumë në kontekstin amerikan të këtij modeli të votimit në William A. Glaser, "The Family and Voting Turnout". *The Public Opinion Quarterly* Vol. 23 No. 4 (Winter, 1959-1960), fq. 563-570.

pushtetin legjislativ dhe, në raste të caktuara, edhe atë kushtetutëbërës). E drejta pasive e zgjedhjes nuk është e ndërgjyqshme (nuk mund të realizohet me rrugë gjyqësore) dhe nuk nënkupton zgjedhje të garantuar për deputet, përkatësisht të drejtë për marrje të postit të deputetit. Kjo e drejtë siguron të drejtën për kandidimit në zgjedhje nën kushte juridikisht të barabarta dhe gëzon mbrojtje juridike në raport me cenimin e kësaj barazie.

Kushtet e fitimit të së drejtës pasive të zgjedhjes mund të jenë të barabarta me ato që kërkohen për fitimin e të drejtës aktive të zgjedhjes (ta zëmë, në **Belgjikë**, **Holandë** dhe **Zvicër**). Kjo nënkupton se për kandidim në zgjedhje nuk kërkohen kushte shtesë apo cilësi të veçanta në raport me ato që kërkohen për çdo votues. Kushtet për fitimin e të drejtës pasive të zgjedhjes, megjithatë, në shumicën e vendeve janë më të ashpra sesa kushtet për fitimin e të drejtës aktive të zgjedhjes (ta zëmë, në **Austri**, **Itali**, **Meksiko**, **Poloni**, **SHBA**). Kjo arsyetohet me nevojën që pushteti të ushtrohet nga qytetarët që kanë lidhje më të ngushtë me shtetin, përvojë më të madhe jetësore dhe, për pasojë, aftësi për shërbim publik.

Në kushte të rrepta, në raport me të drejtën aktive të zgjedhjes, përmendet **mosha** e individëve që dëshirojnë të realizojnë të drejtën pasive të zgjedhjes. Ajo mund të jetë e ndryshme për kandidatët për dhomën e lartë dhe dhomën e ulët të parlamentit si dhe për pretendentë për kryetar republike (shef shteti). Kështu, ta zëmë, në **Francë** e drejta pasive e zgjedhjes për parlament arrihet me moshën 18-vjeçare për **Kuvendin Nacional** dhe 24 vjeç për **Senat**; për **Dhomën e Përfaqësuese** në **Britani të Madhe**, e drejta aktive e zgjedhjes fitohet me moshën 18-vjeçare, kurse për **Dhomën e Lordëve** me arritjen e moshës 21 vjeç; në **Itali**, për **Dhomën e Deputetëve** kërkohet mosha 25 vjeç, kurse për **Senat** mosha 40 vjeç. Përvojë e veçantë jetësore kërkohet për ushtrimin e funksionit të presidentit të republikës, ashtu që këtu për realizimin e të drejtës pasive të zgjedhjes kërkohen mosha të ndryshme: 35 vjeç (në Austri, Rusi, SHBA), 40 vjeç (Gjermani), ose edhe 50 vjeç (Itali).

Si **kusht shtesë** për fitimin e të drejtës pasive të zgjedhje paraqitet **lindja** në shtet (Meksiko, Paraguai, SHBA etj). Gjithashtu, kohëzgjatja e banimit në një vend mund të jetë kusht për realizimin e të drejtës pasive të zgjedhjes. Kështu, ta zëmë, në **Rusi** kandidati për president duhet të ketë banuar në vend së paku 10 vjet pa ndërprerje. Këtë kusht e parashohin mjaft kushtetuta.

Si **kusht negativ** (që nuk guxon të paraqitet) për realizimin e të drejtës negative të zgjedhjes është papajtueshmëria e funksioneve (konflikti i interesit). Ky konflikt mund të jetë i ashpër, ku bartësi i funksionit të caktuar as që guxon të kandidojë në zgjedhje derisa mos të e braktis funksionin që mban (ta zëmë, në **Greqi** dhe **Norvegji**), apo më pak i ashpër, ku bartësi funksionit të caktuar mund të kandidojë por nuk mund të zgjidhet dhe të marrë funksionin. Papajtueshmëria me funksionin e deputetit më së shpeshti ka të bëj me pjesëtarët e ushtrisë, policisë, gjyqtarët, prokurorët, të punësuarit në shërbimet publike (**Greqia dhe shumica e shteteve evropiane**), rangjet aristokratike dhe kleri (**Britania e Madhe**), bartësit e funksioneve në autonomitë territoriale dhe bashkësitë lokale (vendore). E drejta pasive e zgjedhjes mund t'iu kufizohet edhe qytetarëve që janë në vuajtje të dënimit me burg, kur me vendim gjyqësor iu kufizohen të drejtat politike apo janë nën masa të veçanta mbikëqyrjeje (**Britania e Madhe**, **SHBA**).

Përveç këtyre kushteve formale, para të drejtës pasive të zgjedhjes dhe kandidatit paraqitet edhe një kusht përmbajtësor. Ai është **anëtarësia në parti politike** ose **përkrahja partiake kandidaturës së kandidatëve në zgjedhje**. U mor vesh, këtu nuk bëhet fjalë për kusht juridiko-kushtetues, sepse në të gjitha sistemet juridiko-kushtetuese të vendeve demokratike parashihet mundësia e kandidimit të pavarur nën kushtet të caktuara, por për një kusht përmbajtësor, nga plotësimi i të cilit varet suksesi i kandidatit në zgjedhje. Në shtetet e sotme, roli i partive politike është i jashtëzakonshëm, ato zhvillojnë aktivitet pandërprerë, veçanërisht gjatë kohës së zgjedhjeve. Janë partitë politike ato që praktikisht udhëheqin me zgjedhjet, fitojnë ose humbin, ashtu që kandidatëve parazgjedhorë iu

pamundësohet realizimi i të drejtës së tyre pasive të zgjedhjes dhe fitimi i mandatit të deputetit.

E drejta pasive e zgjedhjes realizohet me **kandidim**. Kandidimi mund të jetë individual (uninominal) dhe me lista zgjedhore (plurinominal). **Kandidimi individual** nënkupton që në një njësi zgjedhore kandidojnë individë, prej të cilëve vetëm njëri zgjidhet – ajo/ai që fiton më së shumti vota. Ky kandidim është karakteristikë e sistemeve zgjedhore mazhoritare. **Kandidimi me lista zgjedhore** është mënyrë e kandidimit kolektiv, që nënkupton se ekzistojnë më shumë kandidatë të propozuar nga propozuesi i njëjtë, më së shumti aq sa deputet zgjidhen në njësinë zgjedhore ku ata kandidojnë. Ky kandidim është karakteristikë e sistemeve zgjedhore proporcionale.

Të drejtën për kandidim e kanë qytetarët, bashkësitë e qytetarëve, partitë politike dhe koalicionet e partive politike. Kjo nënkupton se e drejta e kandidimit nuk është një e drejtë individuale, sepse është e domosdoshme që kandidatin ta propozojnë subjektet juridikisht të autorizuara. Kandidatura i dërgohet organit që realizon zgjedhjet – komisionit të zgjedhjeve (ose organit ekuivalent me emër të ndryshëm). Ajo duhet të shoqërohet me dokumentacionin përkatës, me të cilin dëshmohet se kandidati posedon të drejtën pasive të zgjedhjes, si dhe vetë pëlqimin e saj/tij për kandidim. Deri në një moment të caktuar, kandidati mund të heq dorë nga kandidimi, zakonisht deri në pranimin zyrtar të kandidaturës dhe shpalljes së saj nga ana e komisionit zgjedhor.

Kandidimi i pavarur përbën një pjesë të pandashme të demokracive liberale perëndimore. Në vartësi të zgjedhjeve – parlamentare, presidenciale, regjionale ose lokale (vendore) - është e nevojshme që kandidatura të përkrahet nga një numër i caktuar i qytetarëve, në mënyrën e përcaktuar juridikisht, zakonisht përmes nënshkrimeve të vërtetuara. Kjo do të thotë se kandidati merr pjesë në procedurën zgjedhore edhe para shpalljes së kandidaturës, duke vënë si shtojcë mbështetjen e qytetarëve për kandidaturën e vet. Me këtë kandidati dëshmon për relevancën e vet politike edhe para përfundimit të zgjedhjeve. Numri i nënshkrimeve të domosdoshme për kandidim ndryshon nga një shtet në tjetrin dhe varet nga lloji i zgjedhjeve - lokale (vendore) regjionale, nacionale, presidenciale ose parlamentare - si dhe nga ajo nëse kandidimi është individual apo sipas listave. Shkon nga qindra nënshkrime në zgjedhjet lokale (vendore) deri në mijëra e miliona nënshkrime (në zgjedhjet e vitit 2012 në Federatën Ruse, për kandidatët e partive joparlamentare në zgjedhjet presidenciale është nevojitur mbështetja e më së paku një milion qytetarëve; sot kjo shifër është dukshëm më e vogël, 100.000 dhe 3000.000). Për kandidim mund të kërkohet edhe deponimi i një shume të hollash ose vënia nën hipotekë e pasurisë në një vlerë të caktuar (garancioni zgjedhor), që i kthehet kandidatit nëse fiton përqindjen minimale të kërkuar të votave të hedhura (shfrytëzuara). Në këtë mënyrë mbrapsen nga kandidimi kandidatët politikisht joserioz. Krahas krejt këtyre, kandidati duhet të ketë vendbanimin në njësinë zgjedhore në të cilën kandidohet për deputet. Me këtë, kandidati tregon për lidhjen që ka me trupën zgjedhore, të cilën, në rast fitoreje, do ta përfaqësojë në parlament dhe pranë së cilës do të jetë politikisht përgjegjës për punën që bën.

Organi për zbatim të zgjedhjeve shqyrton kandidaturën e paraqitur. Nëse ekzistojnë të meta juridike që mund të mënjanohen, ta zëmë, numri i pamjaftueshëm i nënshkrimeve ose mungesa e ndonjë dokumenti, atëherë jepet një kohë e caktuar për përmirësim ose plotësim të kandidaturës së paraqitur. Nëse paraqitja e kandidaturës nuk mund të përmirësohet në afatin e dhënë ose nëse ajo nuk plotësohet siç duhet, atëherë vjen deri te hedhja poshtë e saj. Parashtruesi i kandidaturës dhe vetë kandidati kanë të drejtë ankese në gjykatë në vendimin mbi hedhjen poshtë ose refuzimin e kandidaturës. Kandidatura e rregullt individuale ose lista e paraqitur zgjedhore pranohet dhe shpallet. Me kalimin e kohës për paraqitjen e kandidatëve përpilohet lista zgjedhore e përbashkët e të gjitha kandidaturave të paraqitura dhe të pranuara.

Me shpalljen e kandidaturës fitohet e drejta e pjesëmarrjes në fushatën zgjedhore, me shpalosjen para qytetarëve të programit vetjak përmes medies dhe në mënyra të tjera – posterë, shpallje (afishime), mitingje etj. Kandidati ka të drejtë që për fushatën zgjedhore të merr mjete nga të ardhurat publike, buxheti, dhe kësisoj t'i mbuloj pjesërisht shpenzimet e fushatës, kurse fituesi fiton mjete shtesë nga buxheti. Kandidati ka të drejtë që drejtpërdrejt ose përmes të tjerëve të marrë pjesë në punën e organeve zgjedhore, që para gjykatës ose organit për zbatim të zgjedhjeve të mbroj barazinë e të drejtës pasive të zgjedhjes, që në rast të fitimit të zgjedhjes të merr vërtetimin nga komisioni zgjedhor dhe të ketë mandatin e verifikuar në parlament.

4. E drejta e votës dhe parakushtet për realizimin e saj

4.1. E drejta e votës

E drejta e votës është realizim i të drejtës aktive të zgjedhjes. Esenca e kësaj të drejte është vetë akti i votimit. Të drejtën e votës e përcjellin të drejtat tjera të votuesve: e drejta për qasje në vendin e votimit, marrjen (pranim) e materialit zgjedhor, votimin e fshehtë, votimin me letër, elektronikisht ose nga shtëpia dhe të drejta të tjera lidhur me organizimin e votimit. Detyrimet e votuesit lidhur me votimin janë: të legjitimohet, të respektoj të gjitha fazat e procedurës së votimit dhe mos të prish rendin dhe qetësinë publike në vendvotim, të mos bëjë propagandë zgjedhore gjatë votimit, të hedh materialin zgjedhor në kutinë e votimit, të respektojë kohën e votimit. Këto të drejta dhe detyrime të votuesve flasin për atë se votimi është një proces formal dhe i organizuar në mënyrë të detajuar, i përbërë nga disa rregulla teknike, ku nuk guxon të ndodhin improvizime.

E drejta e votës realizohet **personalisht**, në mënyrë vetjake, nga ana e personit që ka të drejtën e zgjedhjes. Vetëm përjashtimisht, për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme kur bartësi të drejtës aktive të zgjedhjes nuk mund të votojë vetë sepse ka invaliditet (i verbër, i paralizuar) ose është analfabet, mund të vjen deri te votimi me ndihmën e tjetrit (në **Gjermani**, personat e verbër mund të votojnë vetë në listat e posaçme votuese për të verbrit, me alfabetin e Brajit). Votohet në kushte që sigurojnë fshehtësinë e votës. Kjo do të thotë se në vetë listën e votimit nuk vihen shenjat mbi identitetin e votuesit. Gjithashtu, fshehtësia e votimit nënkupton se janë krijuar kushte të duhura teknike ashtu që personat e tretë mos të kenë qasje në atë se për kënd ka votuar votuesi (mbulesa, hapësira të posaçme, shifra unikate për votim elektronik etj.). Zgjedhjet janë të lira vetëm nëse ekziston votimi i fshehtë. Zgjedhjet janë të **drejtpërdrejta** për shkak se vota i jepet drejtpërdrejt atij që do të jetë deputet në parlament ose shef shteti, jo delegatëve ose elektorëve që do të zgjedhin të tjerët më pas (deputetë dhe shefin e shtetit). Në sistemin zgjedhor mazhoritar, drejtpërdrejtëshmëria është shumë më e shprehur, sepse votohet me emër, për kandidatin konkret. Në sistemin e thjeshtë proporcional me votë individuale të patransferueshme, drejtpërdrejtshmëria është më e vogël, sepse votohet për listën zgjedhore ose për bartësin e saj. Pas kësaj, mandatet nga lista zgjedhore iu shpërndahen kandidatëve brenda listës dhe nuk mund të bëhet fjalë për votën e dhënë drejtpërdrejt kandidatit të dëshiruar. Për këtë arsye në vendet me këtë sistem zgjedhor shpeshherë thuhet se kandidatët e zgjedhur nuk përfaqësojnë popullin sepse nuk janë zgjedhur drejtpërdrejt nga ai.

Votimi mund të organizohet në vendvotim, por edhe jashtë tij. Si rregull, votimi bëhet në vendin e paracaktuar, në hapësirat e shënuara që më parë (ndërtesë apo institucion administrativ), në kohën e caktuar, gjatë një ose më shumë ditëve (në **Indi** votohet deri në 40 ditë). Qytetari më herët lajmërohet për vendin e votimit. Nëse qytetari gjendet për një kohë të gjatë jashtë vendbanimit të zakonshëm të vet, siç janë situatat e vuajtjes së dënimit me burg, kryerja e shërbimit ushtarak, qëndrimi në botën e jashtme dhe ngjashëm me këto, atëherë votimi mund të organizohet në vende të posaçme (në burg, kazermë ushtarake, përfaqësi diplomatike dhe konsullore etj.), ose mund të votohet me letër, në kohë të fundit edhe në mënyrë elektronike. Votimi mund të ndodhë edhe në adresën ku banon votuesi, ku organet për zbatim të zgjedhjeve dërgojnë materialin zgjedhor. Kjo iu mundësohet qytetarëve

që paraprakisht i kanë lajmëruar problemet e tyre serioze shëndetësore, vështirësitë në lëvizje dhe kështu me radhë. Votimi jashtë vendit të votimit mund të organizohet edhe në mënyrë elektronike, përmes internetit, mirëpo kjo akoma nuk është standard përgjithësisht i pranuar dhe gjendet në fazën e testimit (**Estonia**, **Franca**, **Zvicra**, **SHBA** etj).

Aktualisht mbizotëron votimi me listë votuese, përmes rrumbullakimit të numrit rendor apo emrit të kandidatit. Mënyra themelore e votimit është me **votim individual**. Në sistemet zgjedhore proporcionale dhe sistemet zgjedhore të përziera mund të votohet edhe me dy vota – një për listën zgjedhore, kurse tjetri për kandidatin individual. Ekziston edhe mënyra e ndërlikuar e votimit, që praktikohet në disa vende. Esenca e këtyre mënyrave është që të shprehet sa më saktësisht vullneti politik i votuesit, i cili në rastin më të shpeshtë nuk është (por as nuk ka nevojë domosdo që) krejtësisht (të jetë) i përcaktuar për një kandidat apo listë zgjedhore. Ka disa lloje të këtij votimi: njëri prej tyre bëhet përmes **votës së bartshme individuale**, e cila mund të ndahet në mënyrë alternative për disa kandidatë, ta zëmë: zgjedhja apo alternativa e parë, zgjedhja apo alternativa e dytë dhe kështu me radhë; tjetri lloj është ai i **votës preferenciale**, që përbëhet nga pikët që ndahen në mënyrë matematikore apo gjeometrike ose pikët grumbullohen (mblidhen) dhe i ndahen njërit ose disa prej kandidatëve; së fundi vjen e a.q. **panachage** ("panashazhimi"): kjo në fakt është përpilim i listës vetjake të kandidatëve me votim për kandidatët nga listat e ndryshme.[13]

4.2. Regjistri i votuesve

Regjistri i votuesve është regjistri publik i qytetarëve që kanë të drejtën e zgjedhjes. Nëse qytetari më të drejtën e zgjedhjes, pra qytetari që i plotëson kushtet për të gëzuar të drejtën e zgjedhjes, për një arsye ose tjetër nuk është i regjistruar në regjistrin e votuesve, kjo nuk do të thotë si ajo/ai ka humbur të drejtën në fjalë. Qytetari edhe në një situatë të tillë gëzon të drejtën e zgjedhjes, gjithnjë me supozimin që ka plotësuar kushtet për fitimin e kësaj të drejte, që i diskutuam më sipër. Këtë të drejtë qytetari, megjithatë, nuk mund ta shfrytëzoj nëse nuk gjendet në regjistrin e votuesve. Vetëm regjistrimi në regjistrin e votuesve e aktivizon këtë të drejtë.

---

[13] Fjala "panachage" rrjedh nga frëngjishtja dhe do të thotë "përzierje". Kjo procedurë votimi gjen zbatim në sistemin proporcional zgjedhor me listat e partive, kryesisht në variantin me lista të hapura. Kjo procedurë i jep mundësi votuesve për më shumë se një votë në të njëjtën kuti votimi dhe u lejon atyre shpërndarjen e votës mes kandidatëve individual nga listat e ndryshme partiake. Përdoret në zgjedhjet e të gjitha niveleve në **Lihtenshtajn**, **Luksemburg** dhe **Zvicër**, vetëm në zgjedhjet kongresionale në Ekuador, El Salvador dhe Honduras, kurse vetëm në zgjedhjet lokale (vendore) në shumicën e shteteve gjermane, në Çeki dhe në komunat franceze nën 1,000 votues.Në kuadër të sistemeve zgjedhore joproporcionale, procedurat "votimi gjerësisht plural" ("plurality-at-large"), "votimi kufizuar" ("limited voting") dhe "votimi kumulativ" ("cumulative voting") gjithashtu mund të lejojnë individët të shpërndajnë votat e tyre mes kandidatëve nga partitë e ndryshme. Te rasti i **votimit gjerësisht plural**, nganjëherë i njohur edhe si "vota bllok" ose "votimi me bllokim", është sistem joproporcional votimi për zgjedhje të përfaqësuesve në zgjedhjet me shumë fitues. Ky sistem votimi është i pamjaftueshëm për fitimin e përfaqësimit proporcional. Në vend të kësaj, rezultati i zakonshëm ndahet mes partive, partia më popullore në nivel qarku merr krejt kandidatët dhe fitorja duket sikur të ishte fitore e plotë. Shprehja "votimi gjerësisht plural" është në përdorim të përgjithshëm në zgjedhjet për anëtarët përfaqësues të një trupi që janë zgjedhur ose caktuar për të përfaqësuar krejt anëtarësinë e turpit (ta zëmë, krejt qytetin, shtetin, krahinën, kombin, klubin ose asociacionin). Të **votimi kufizuar**, i njohur edhe si "votimi parcialisht bllok" ("partial block voting") zgjedhësit kanë më pak vota se pozitat (vendet) për të cilat votohet. Pozitat iu ndahen kandidatëve që fitojnë shumicën absolute të votave. Në raste shumë të veçanta ku votuesi mund të votoj vetëm për një kandidat kurse janë dy ose më shumë pozita, atëherë sistemi quhet "sistemi i votës së vetme të patransferueshme") ("single non-transferable vote") apo edhe sistemi i "votës rreptësisht të kufizuar" ("strictly limted vote"). Së fundi, **votimi kumulativ** është metodë me më shumë fitues, që ka për synim promovimin e përfaqësimit proporcional, më shumë sesa të zgjedhjeve "fituesi i merr krejt" ("winner takes all"), siç janë "votimi bllok" ose "i pari fiton". Ky lloj votimi përdoret shumë shpesh në qeverisjen korportaiviste. Është i mandatuar në shtatë shtete të **SHBA**. Cf. më shumë për këtë në: *Electoral Systems* (ACEA: 2005). Në internet: https://aceproject.org/ace-en/topics/es/default (shikuar më 2 shtator 2022); *Electoral System Design Database Codebook* (International IDEA, 2018). Në internet: https://www.idea.int/publications/esd/index.cfm (shikuar më 2 shtator 2022).

Në regjistrin e votuesve futen edhe qytetarët që nuk kanë plotësuar të gjitha kushtet për fitimin e të drejtës së zgjedhjes, por është e sigurt se do t'i plotësojnë ato deri në ditën e zgjedhjeve. Në këtë mënyrë, të miturit që arrijnë moshën madhore deri në ditën e zgjedhjeve, regjistrohen në regjistrin e votuesve. Regjistri i votuesve udhëhiqet sipas detyrës zyrtare. E udhëheq organi shtetëror, organi i administratës, si **regjistër unik zgjedhor i të gjithë qytetarëve me të drejtë vote**, ose si **regjistra të veçantë zgjedhor nëpër njësi zgjedhore** ose në **nivel të vetëqeverisjes lokale** (vendore). Edhe atëherë kur udhëhiqet regjistri unik i zgjedhësve, kjo nuk do të thotë se nuk mund të ekzistojnë regjistra të posaçëm të votuesve, siç janë: regjistrat e zgjedhësve që jetojnë në botën e jashtme, regjistrat e minoriteteve dhe kështu me radhë.

Udhëheqja e regjistrit të zgjedhësve sipas detyrës zyrtare nënkupton se të dhënat mbi votuesit futen dhe ndryshohen nga ana e organit që udhëheq me regjistrin në fjalë. Bëhet fjalë për të dhënat themelore personale dhe të dhënat mbi vendbanimin. Ndryshimi, plotësimi dhe fshirja e të dhënave nga regjistri i zgjedhësve mund të kryhet edhe sipas kërkesës së individit. Paraprakisht, qytetarit duhet të ketë qasje në të dhënat e regjistrit të votuesve, që të vërtetoj nëse është i regjistruar në regjistër dhe nëse të dhënat lidhur me të janë të sakta.

Regjistri i votuesve është një evidentim i përhershëm dhe i përditësuar i qytetarëve që kanë të drejtën e zgjedhjes, për të cilin vlen supozimi se të dhënat në të janë të sakta. Regjistri rregullisht përditësohet, në veçanti në prag të zgjedhjeve. Në kohë para zgjedhjeve, qytetarët rregullisht ftohen që të bëjnë rishikimin dhe përditësimin e të dhënave të tyre, të cilat më pas mbyllen dhe shpallen, duke treguar numrin përfundimtar të qytetarëve me të drejtë vote. Kjo ka rëndësi për shkak se ndihmon në konstatimin e daljes në zgjedhje dhe rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, nëse është fituar në raundin e parë të zgjedhjeve, sa është pragu zgjedhor dhe kështu me radhë.

4.3. Listat zgjedhore

Kandidimi në listat zgjedhore është karakteristikë e sistemeve zgjedhore proporcionale. Parashtrues të listave zgjedhore, në të shumtën e rasteve janë partitë politike dhe koalicionet partiake, e shumë më rrallë parashtrues janë vetë qytetarët, të bashkuar rreth ndonjë liste konkrete zgjedhore për zgjedhjet e caktuara. Kandidatura përmes listave partiake zgjedhore është karakteristikë edhe për atë se vetë kandidatët është dashur të kalojnë një proces përzgjedhës paraprak. Përzgjedhja brenda partisë politike, ku zgjedhësit nuk kanë ndikim, shërben si rrugë për nominim të kandidatëve për listën zgjedhore. Votuesit mund të mos jenë të pajtimit me disa prej tyre, ose me shumicën e tyre, por sërish mund të votojnë për partinë që paraqet listën zgjedhore, dhe atë për disa arsye: përkrahin liderin e partisë, janë përkrahës të programit politik të partisë dhe kështu me radhë. Për të zvogëluar këtë hendek që mund të krijohet në mes të votuesit dhe kandidatëve, ekzistojnë lista të ndryshme zgjedhore në të cilat zgjedhësit mund të deklarohen edhe vetëm për kandidatin, jo edhe vetëm për listën zgjedhore si tërësi.

Lista të mbyllura zgjedhore janë ato në të cilat votuesi votën ia jep listës si tërësi, rrumbullakon numrin rendor të listës zgjedhore apo emrin e bartësit të listës (Italia). Brenda listave të mbyllura zgjedhore ekzistojnë **listat e bllokuara** (e lidhura), të cilat kanë renditjen e pandryshueshme të kandidatëve. Këtu mandatet kandidatëve ndahen sipas renditjes së tyre në listën zgjedhore, aq mandate sa janë fituar në tërësi. Si **lista të pabllokuara** (të palidhura) janë ato në të cilat bartësi i listës mund t'ua ndaj mandatet kandidatëve, pa respektuar renditjen e tyre në listën zgjedhore. Këtu, praktikisht, zgjedhja reale e deputetëve gjendet në duart e lidershipit partiak. Ajo me të cilën mund të jetë e lidhur oligarkia partiake te listat e mbyllura zgjedhore, si me rastin e nominimit të kandidatëve ashtu edhe tek përzgjedhja e deputetëve, janë **kuotat e përfaqësimit** të grupeve të caktuara. Me këtë rast, një përqindje e caktuar e mandateve, zakonisht 30 deri 40 % nga numri total që ka fituar lista zgjedhore, duhet t'iu ndahet kandidatëve që i takojnë gjinisë më pak të përfaqësuar.

Listat e hapura zgjedhore janë ato lista në të cilat zgjedhësi votën e vet mund t'ia jep njërit prej kandidatëve brenda listës zgjedhore, përkatësisht mund të bëj ndërhyrje siç janë: ndryshimi i renditjes së kandidatëve, shkruarja ose fshirja e kandidatëve. Në këtë mënyrë, votuesi precizon zgjedhjen e vet, ashtu që vetë votimi përfaqëson një shprehje të saktë të vullnetit politik të votuesit, krahasuar me situatën kur votuesi duhet të jep votën vetëm për listën zgjedhore. Hapja e këtyre listave zgjedhore është e ndryshme, nga listat fleksibile, që nënkupton të drejtën për ndryshim të renditjes së kandidatëve, deri te listat e lira që i përpilojnë vetë votuesit nga kandidatët e partive të ndryshme politike.

E ndryshme është edhe mënyra e votimit te zgjedhjet me **listat të mbyllura** dhe te **zgjedhjet me listat të hapura.** Vota individuale e transferueshme është karakteristikë e listës zgjedhore të mbyllur. Vota këtu i jepet vetë listës zgjedhore. Mënyrat e votimit në listat e hapura zgjedhore mund të jenë të ndryshme. Votuesit mund të kenë dy vota, ashtu që njëra votë mund t'i jepet listës zgjedhore e tjetra kandidatit brenda listës zgjedhore (Bosnje-Hercegovina, Polonia, Suedia). Mandatin e fitojnë kandidatët që marrin më së shumti këso votash" të tjera". E drejta aktive e zgjedhjes mund të nënkuptoj edhe më shumë vota apo pikë – aq sa është numri deputetëve që zgjidhen në listën zgjedhore ose më pak se ai numër. Këtu votohet në atë mënyrë që ato vota ose pikë, votuesi ua shpërndan të gjithëve, disa kandidatëve apo vetëm njërit prej kandidatëve (**vota kumulative**). Në këtë mënyrë, votuesi bën radhitjen vetjake të kandidatëve, duke vendosur se cili kandidat për të është i pari, cili i dyti, cili i treti dhe kështu me radhë, kurse mandatet në fund ndahen sipas formulave të posaçme matematikore (Australia, Irlanda).

Listat e posaçme zgjedhore janë ato në të cilat si kandidatë paraqiten pjesëtarët e grupeve të caktuara shoqërore. Më të njohura ndër to janë listat zgjedhore të pakicave kombëtare, të cilave në njësi të veçanta zgjedhore iu garantohet një numër i caktuar i mandateve (Kroacia, Mali i Zi, Kosova etj.). Ekzistojnë edhe lista të posaçme zgjedhore për kandidatët për deputete gra (në **Indi**, ta zëmë, ekzistojnë edhe listat e burrave dhe listat e përziera).

4.4. E drejta për informim mbi zgjedhjet dhe fushata zgjedhore

Qytetarët kanë të drejtë të jenë të informuar mbi zgjedhjet si tërësi, me procedurën e zgjedhjeve dhe në veçanti mbi aktivitetet e pjesëmarrësve në zgjedhje.

Qytetarët kanë të drejtë të kenë informata objektive lidhur me zgjedhjet: cilat zgjedhje janë shpallur dhe kur mbahen, numri zgjedhësve, çfarë duhet të bëjnë për të votuar, ku dhe si votohet, cilave organe iu drejtohen për mbrojtjen e të drejtave të tyre zgjedhore. Ata informohen edhe lidhur me atë se kur prezantohen kandidatët dhe listat zgjedhore në media, kur organizohet debati, cilat aktivitete do të ndërmarrin kandidatët gjatë fushatës zgjedhore, ku dhe si shpalosen programet zgjedhore të kandidatëve. Për këtë i informojnë organet për zbatimin e zgjedhjeve përmes komunikatave për media, shpalljeve apo me anë të dorëzimit të ftesave dhe informatave të tjera në adresën e votuesve. Pjesa më e madhe e këtyre informatave përcillet me medie elektronike, në rend të parë përmes radio-televizioneve, më pas përmes medies së shkruar (shtypit) dhe, çdo ditë e më shumë, edhe përmes internetit.

Grupin e dytë të informatave e përbëjnë ato që qytetarët i marrin në fushatë zgjedhore. Ato informata nuk janë politikisht neutrale sepse paraqesin propagandën politike në dobi të kandidatëve. Fushata zgjedhore përbëhet nga aktivitetet e nduarnduarta, me të cilat promovohet kandidati në zgjedhje me qëllim të realizimit të një rezultati sa më të mirë zgjedhor. Nuk është e gabuar të thuhet se në kushtet e sotme të fushatës zgjedhore totale, suksese në zgjedhje më së shumti varet nga **marketingu zgjedhor**.

Fushatën zgjedhore e organizojnë **ekspertët e marketingut zgjedhor,** apo, siç quhen nganjëherë "spin doktorët", të cilët kandidatët dhe programin e tyre zgjedhor provojnë t'ua ofrojnë sa më afër votuesve potencialë, interesave dhe qëndrimeve (pikëpamjeve) të tyre. Fushata zgjedhore mund të drejtohet

kah një grup i posaçëm me qëllim, siç janë punëtoret, gratë, grupet minoritare, por edhe mund të ketë karakter të fushatës për të gjithë, përkatësisht karakter përgjithshëm dhe popullist. Formë e veçantë është **fushata negative**. Qëllimi i saj është që me kritikë, të bazuar apo pa asnjë bazë, qytetarët të zmbrapsen nga votimi i kandidatëve të tjerë apo konkurrenti kryesor në zgjedhje. Në parim ndalohet kjo lloj kritike dhe për sanksionimin e saj përkujdesen organet në ngarkesë për zbatim ose mbikëqyrje të zgjedhjeve.

Mjetet me të cilat udhëhiqet fushata zgjedhore janë të ndryshme. Në mjetet elektronike, në rend të parë në radio-televizion, përveç paraqitjes pa pagesë të kandidatëve, mjaft intensiv është edhe marketingu zgjedhor i kandidatëve në kuptim të ngushtë. Bëhet fjalë për paraqitje të shkurtra, spote, filma promovues, paraqitje me pagesë nëpër emisione radio-televizive etj. Hapësirë gjithnjë e më të rëndësishme në fushatë zgjedhore po merr komunikimi me internet, paraqitja dhe promovimi në portale vetjake, dërgimet me postë elektronike, promovimi përmes rrjeteve sociale dhe kështu me radhë. Mënyra tjetër e paraqitjes së kandidatëve është përmes medies së shkruar, posterëve, bilbordëve si dhe dërgimit të mesazheve zgjedhore përmes rrugëve të tjera (reklama të ndriçuara, dërgimi i materialeve promovuese në adresa individuale etj.). Organizimi i mitingjeve zgjedhore, takimeve me qytetarë, vizita institucioneve, fabrikave, shtëpive, lagjeve, gjithashtu janë mënyrë e udhëheqjes së fushatës zgjedhore.

Me qëllim të pajtimit të dy kërkesave - sigurimi i lirisë së vendosjes së votuesit për votim dhe sigurimi i hapësirës së duhur për të gjithë kandidatët për paraqitjen e programit të tyre zgjedhor - në disa shtete **ndalohet marketingu zgjedhor me pagesë**, duke mundësuar paraqitja pa pagesë përmes medies (ta zëmë, Britania e Madhe dhe vendet skandinave). Në Francë ndalohet marketingu politik në periudhën zgjedhore. E kundërt me këto praktika është rasti i **SHBA-së**, ku fushata zgjedhore për president është tepër intensive, e gjatë dhe shumë e shtrenjtë (deri në dy miliard dollarë), me aktivitete publike që shërbejnë si shembull tipik i marketingut total me pagesë. Kjo është krejtësisht ndryshe në **Francë**, ku shefi i shtetit ka autorizime kushtetuese thuajse të njëjta me ato të shefit të shtetit amerikan: katër kandidatë francezë për president në vitin 2017, marrë së bashku kanë shpenzuar më pak se 60 milion euro, në ndërkohë që fushata presidenciale amerikane një vit më herët, në vitin 2016, ka kushtuar rreth 1.16 miliard dollarë (në vitin 2012 ka kushtuar rreth 1.97 miliard dollarë).[14]

Në numrin më të madh të shteteve, qytetarët lirohen nga presioni i marketingut zgjedhor ditën e votimit, ashtu që futet **heshtja zgjedhore**. Gjatë kohës sa zgjatë heshtja, një ose dy ditë para mbajtjes së zgjedhjeve e deri në përfundimin e tyre ndërpriten aktivitetet zgjedhore dhe ndalohet marketingu zgjedhor. Këto masa ligjore, megjithatë, nuk mjaftojnë sepse aktivitetet e ndërmarra gjatë fushatës zgjedhore ngelin të dukshme, siç janë: shpalljet, informacionet në internet, posterët dhe bilbordët në rrugë etj.

5. Procedura zgjedhore dhe njësitë zgjedhore

Zgjedhjet kryhen nëpër njësi zgjedhore, si territor brenda shtetit ku shpërndahet trupa e tërësishme zgjedhore. Në njësitë zgjedhore qytetarët votojnë për një ose më shumë kandidatë, të cilët së bashku me kandidatët e zgjedhur nga njësitë tjera zgjedhore hyjnë në organin përfaqësues – parlament. Në zgjedhjet presidenciale, zgjedhësit votojnë si trup unik zgjedhor, pa marrë parasysh se në sa njësi zgjedhore janë formalisht të ndarë. Ekziston mundësi për formim të vendvotimeve jashtë shtetit. Me këtë mundësohet votimi i atyre që gjenden jashtë vendit.

[14] Cf. më shumë në "2012 Presidential Race". *Open Secrets*. Në internet: https://www.opensecrets.org/pres12/ (shikuar më 4 shtator 2022) & "2016 Presidential Race". *Open Secrets*. Në internet: https://www. opensecrets. org/pres16 (shikuar më 4 shtator 2022).

5.1. Procedura zgjedhore

Procedura zgjedhore është realizim i zgjedhjeve dhe përbëhet nga disa veprime juridike dhe materiale që janë paraprakisht të përcaktuara juridikisht. Zgjedhjet përfshijnë kohën nga shpallja e zgjedhjeve deri te shpallja e rezultateve përfundimtare, përfshirë verifikimin e mandateve të fituara. Në kohën ndërmjet zgjedhjeve, periudha mes dy palë zgjedhjeve, gjithashtu ndërmerren veprime juridike dhe materiale lidhur me zgjedhjet: miratimi dhe ndryshimi i dispozitave që normojnë zgjedhjet, përditësimi i listës së zgjedhësve, ndryshimi i kufijve të njësive zgjedhore, përgatitja e pjesëmarrësve për zgjedhje (shkrimi i programit zgjedhor, përzgjedhja e kandidatëve, negociatat dhe koalicionet, mbajtja e mbledhjeve të komisionit qendror të zgjedhjeve).

Në procedurën zgjedhore marrin pjesë një rreth i madh i subjekteve. Organi që organizon dhe realizon zgjedhjet për parlamentin nacional dhe presidentin e republikës është komisioni qendror i zgjedhjeve, drejtpërdrejt dhe përmes komisioneve më të ulëta zgjedhore dhe këshillave zgjedhore. Ai mund të ketë emërtime të ndryshme në vende të ndryshme. Kjo nuk ka rëndësi: ajo që çon peshë është funksioni që kryen lidhur me zgjedhjet. Krahas organeve zgjedhore, në procedurën zgjedhore marrin pjesë edhe organizma të tjerë siç janë: organet që shpallin zgjedhjet, organet që mbrojnë të drejtat zgjedhore dhe zgjidhin mosmarrëveshjet zgjedhore, qytetarët si bartës të së drejtës aktive dhe pasive zgjedhore, propozuesit e kandidatëve në zgjedhje, vëzhguesit vendorë dhe të huaj dhe mediat si pjesëmarrëse në fushatë zgjedhore. Të gjithë këto subjekte kanë të drejta e detyrime të ndryshme, të cilat normohen me dispozitat mbi zgjedhjet.

Të drejtën për shpallje të zgjedhjeve e kanë organet e autorizuara me kushtetutë ose ligj. Ato mund të jenë: shefi i shtetit, kryetari i parlamentit, kryetari i qeverisë, kryetari i komisionit zgjedhor (**Kanada**), guvernatori i përgjithshëm (**Australi**). Zgjedhjet e rregullta parlamentare shpallen para mbarimit të mandatit të parlamentit, në kohën e përcaktuar me kushtetutë ose ligj dhe atë para përfundimit të mandatit të përbërjes paraprake. Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare është politik dhe pasojë e shpërndarjes së parlamentit. Në rastet kur i njëjti organ shpall zgjedhjet dhe shpërndan parlamentin, atëherë ai një gjë të tillë e bën përnjëherë. Në disa vende, vendimi për shpalljen e zgjedhjeve është krejtësisht formal, siç është rasti me **Kongresin e SHBA-së**, sepse zgjedhjet për senatorë (një të tretën e tyre) mbahen çdo vit çift, të martën e parë pas të hënës së parë në nëntor. Vendimin për shpallje, formalisht e nxjerrin (kryesisht) guvernatorët e shteteve federale amerikane. Në disa vende, ligjërisht nuk ekziston fare një kohë e saktë për shpalljen e zgjedhjeve, Përveç përcaktimit se ato duhet të mbahen në çdo pesë vjet (**Britania e Madhe**): vendimi për zgjedhjet britanike për Dhomën e Përfaqësuesve është vendim politik i qeverisë (ekzekutivit), që merret në momentin më të volitshëm sipas vlerësimit të saj për arritjen e rezultatit sa më të mirë. Me vendimin e monarkut britanik, me të cilin shpërndahet Parlamenti (Dhoma e Lartë), formalisht vjen deri te shpallja e zgjedhjeve të përgjithshme (së bashku me vendimin e sekretarit të Kurorës britanike për secilën njësi zgjedhore) dhe mbahen pas 25 ditë pune, sipas rregullit të enjten.

Vendimi mbi shpalljen e zgjedhjeve përmban të dhënat mbi llojin e zgjedhjeve: parlamentare, presidenciale, regjionale, lokale (vendore), të rregullta, të parakohshme si dhe kohën e votimit. Nga shpallja e tij fillojnë të rrjedhin afatet për paraqitjen e kandidatëve dhe veprimet tjera zgjedhore.

Pas nxjerrjes së vendimit ndërmerren veprime të ndryshme zgjedhore: listat zgjedhore ose kandidatët individual i dorëzohen komisionit zgjedhor, së bashku me dokumentacionin e duhur, zgjidhen personat që marrin pjesë në organizimin e zgjedhjeve në vendvotime, caktohen vendet për votim, përgatiten listat e votimit, kutitë dhe materiali tjetër iu dërgohet vendvotimeve, përditësohet dhe mbyllet lista zgjedhore.

Votimi bëhet në vendvotimin e rregulluar për atë qëllim, kurse përjashtimisht edhe jashtë tij – në vendbanim. Si rregull, qytetarët votojnë pas identifikimit personal të tyre, më pas plotësohet lista votuese dhe vihet në kutinë e votimit.
Procesi votimit përfundon me kalimin e kohës së përcaktuar ligjërisht dhe më pas ndërmerren veprimet zgjedhore me qëllim të konstatimit të rezultatit zgjedhor. Listat e votuese klasifikohen në: të përdorura, të papërdorura, të vlefshme dhe të pavlefshme. Pas numërimit të listave të vlefshme votuese konstatohen rezultatet e votimit – numri i votave për secilin kandidat, përkatësisht për listën zgjedhore dhe kjo futet në formular të veçantë. Numërimi i votave është më i komplikuar nëse bëhet fjalë për votim preferencial, votim me më shumë pikë ose vota: atëherë rezultatet vërtetohen në nivel të njësisë zgjedhore, jo të vendvotimit. Nëse votohet përmes makinave të posaçme për votim, rezultatet vërtetohen përmes numërimit elektronik të votave.

Rezultatet për parlament i vërteton dhe shpall komisioni qendror i zgjedhjeve, kurse komisionet e posaçme zgjedhore – zgjedhjet regjionale dhe lokale (vendore). Pas mbarimit të kontesteve zgjedhore eventuale dhe përsëritjes së votimit, vërtetohen dhe shpallen rezultatet përfundimtare zgjedhore. Pas kësaj, komisioni zgjedhor e lëshon vërtetimin mbi zgjedhjen personit të zgjedhur, i cili me këtë pranon funksionin. Mandatet e deputetëve i vërteton parlamenti. Materiali zgjedhor: listat votuese, formularët, procesverbalet, për një kohë të caktuar ruhen si material arkivor (disa vite ose përgjithmonë).

5.2. Njësitë zgjedhore

Disa vendvotime përbëjnë një **njësi zgjedhore**. Sipas rregullit, brenda shtetit ekzistojnë disa njësi zgjedhore, e më rrallë vetëm një. Kur ekziston vetëm një njësi zgjedhore, atëherë ajo ka disa përparësi matematikore, më saktësisht këtu vjen deri të reflektimi më besnik i mandateve të fituara në parlament në proporcion me votat e marra. E meta kryesore përmbajtësore e saj është se zgjedhësit nuk dinë kë votojnë e as kandidatët nuk dinë kujt t'i drejtohen. Numri i njësive zgjedhore, kufijtë dhe madhësia e tyre ndikojnë në një masë të caktuar në rezultatin zgjedhor.

Ekzistojnë dy lloje të njësive zgjedhore: njëmandatore (uninominale), ku zgjidhet një deputet, dhe shumëmandatore (plurinominale), ku zgjidhen më shumë deputetë. Për rezultatet zgjedhore e rëndësishme është edhe ndarja në njësi zgjedhore urbane dhe njësi zgjedhore rurale. Njësi zgjedhore me një mandat janë tipike për sistemet zgjedhore mazhoritare, ku garojnë individët. Njësitë zgjedhore me më shumë mandate, ndërkaq, janë tipike për sistemet proporcionale zgjedhore, ku marrin pjesë listat zgjedhore. Njësitë zgjedhore **uninominale** janë të vogla dhe janë po aq sa numri deputetëve që zgjidhen. Njësitë zgjedhore **plurinominale** kanë më shumë zgjedhës se sa njësitë uninominale, kurse numri i tyre më së shpeshti është produkt i marrëveshjes politike. Këto njësi mund ndahen në të vogla (zgjidhen tre deri pesë deputetë), të mesme (zgjidhen deri në dhjetë deputetë) dhe, së fundi, të mëdha (zgjidhen më shumë së dhjetë deputetë). Më e madhe njësia zgjedhore, më i madh proporcioni në mes të numrit të votave të fituara dhe mandateve.

Kriteret mbi bazën e të cilave formohen njësitë zgjedhore janë të ndryshme. Pikë nisme është që trupi zgjedhor si tërësi ndahet në njësi zgjedhore ashtu që çdo votë të ketë vlerë të njëjtë ose afërisht të njëjtë. Kjo nënkupton që numri i njëjtë, ose afërisht i njëjtë i qytetarëve, zgjedh numër të njëjtë të deputetëve. Kështu, ta zëmë, 150.000 votues të regjistruar në njësinë zgjedhore A zgjedhin tre deputetë, kurse 300.000 votues të regjistruar në njësinë zgjedhore B zgjedhin gjashtë deputetë. Përkundër që proporcioni i saktë kurrë nuk mund të arrihet dhe, për pasojë, as votat të barazohen tërësisht për nga vlera e tyre, një gjë e tillë duhet të synohet. Për shkak të migrimit të popullsisë, nga provinca në metropol, nga vendet rurale në vendet urbane, ekziston nevoja që të kihet parasysh vlera e njëjtë e votës. Për këtë duhet të ndryshojnë kufijtë e njësive zgjedhore, më shpesh i atyre unnominale, kurse në njësitë plurinominale, problemi mund të tejkalohet me rritjen ose zvogëlimin e numrit të deputetëve që zgjidhen.

Kriteret tjera që merren parasysh me rastin e formimit të njësive zgjedhore janë: **kriteri administrativ** - kufijtë e njësive zgjedhore ndjekin ndarjen (vijën) administrative të shtetit, kufijtë e komunave, rretheve, regjioneve etj.; **kriteri gjeografik** – përfshijnë hapësirat gjeografikisht të rrumbullakuara, siç janë ujdhesat, brigjet, qytetet apo lagjet para qyteteve në të cilat gravitojnë vendbanimet përkatëse; **kriteri etnik** – njësia zgjedhore përfshinë numrin më të madh të pjesëtarëve të bashkësisë etnike pakicë; **kriteri tradicional** – njësia zgjedhore përfshinë territorin që ka ose ka pasur subjektivitet përgjatë historisë apo tradicionalisht ka qenë e tillë (ta zëmë, famullitë në Angli); **kriteri ekonomik** – njësia zgjedhore përfaqëson një tërësi ekonomike të lidhur. Këto kritere mund të kombinohen me rastin e formimit të njësive zgjedhore. Si raste të posaçme janë njësitë zgjedhore ”universitare”, ku zgjidhen kandidatët nga universiteti (dy të tilla ekzistojnë për Senatin në **Irlandë**) ose njësitë zgjedhore “funksionale”, ku zgjidhen kandidatët e profesioneve të ndryshme (rast i tillë ekziston në **Hong Kong**).

5.3. “Xherimanderingu”

Me rastin e formimit të njësive zgjedhore dhe caktimit të kufijve të tyre, nuk mund të neglizhohet roli dhe rëndësia që kanë kriteret dhe qëllimet politike, siç janë: arritja e një rezultati zgjedhor sa më të mirë, dobësimi i partisë politike opozitare, zvogëlimi i ndikimit politik të grupit minoritar etnik dhe tjetër dhe kështu me radhë. Mënyra më e njohur e caktimit të numrit dhe kufijve të njësive zgjedhore, me qëllim fitimin e zgjedhjeve, quhet **xherimandering** (nga fjala angleze: gerrymandering).

Kjo mënyrë ka lindur në SHBA dhe lidhet me emrin e guvernerit të Masaçusetsit (Massachusetts), **Elbrixh Xhery** (Elbridge Gerry:1744-1814), me vonë nënkryetar i SHBA-ve (1812), i cili kishte rregulluar që kufijtë e një njësie zgjedhore në shtetin e tij, kufijtë e **Eseks**-it, në zgjedhjet për Senatin amerikan, të caktoheshin krejt në mënyrë jo të zakonshme për kohën. Këta kufij, në rrethinat e **Bostonit**, e paraqisnin një kafshë imagjinare me kokën e gjarprit, krehër dhe kthetra. Për këtë arsye u cilësua edhe si **salamander**, me kuptim kafshën me të njëjtin emër. Me këtë veprim, Xhery arriti që të rirregullonte kufijtë zgjedhorë në favor të votuesve të Partisë Demokratike, por jo me sukses të madh, sepse kufij u rikthyen siç duhet një vit më pas.[15] Xherimanderingu si një mënyrë e caktimit joobjektiv dhe me anime të kufijve të njësive zgjedhore dhe caktimit të numrit të deputetëve që zgjidhen në të, megjithatë, me kohë u shndërrua në një dukuri mjaft të përhapur. Ai sot, kohë pas kohe, shërben si mjet për manipulim zgjedhor në shumë shtete (Britania e Madhe, Francë, Kanada etj.) dhe mund të cilësohet si një fenomen i përgjithshëm zgjedhor (me përjashtim të shteteve me një njësi zgjedhore).

Për realizimin e xherimanderingut është e domosdoshme të ekzistojnë njohuri të verifikuara dhe supozime të themelta mbi atë se si do të votojnë zgjedhësit e një hapësire të caktuar që do të jetë objekt i rirregullimi përmes tij. Më së shpeshti, deri te përfundimi mund të arrihet në bazë të vlerësimit që kanë partitë politike për zona tradicionalisht me votues të tyre, qoftë për shkak se i takojnë grupit të njëjtë fetar, etnik, gjuhësor dhe tjetër, apo shtresës përkatëse shoqërore, zonave rurale ose urbane dhe kështu me radhë. Përveç kësaj, anketat me votues lidhur me pikëpamjet e tyre politike mund të shërbejnë si bazë për xherimandering.

Të zakonshme janë dy mënyra të realizimit të xherimanderingut. Njëra mënyrë është **paketimi** (angl.: packing) i përkrahësve të partisë së caktuar politike ose kandidatëve në një njësi zgjedhore. Me këtë synohet fitimi i mandateve në njësinë zgjedhore uninominale ose i më shumë sosh në njësinë zgjedhore plurinominale (shumë rrallë i të gjitha mandateve). Më mënyrën e dytë synohet ndarja apo çarja (angl.: cracking) në më shumë njësi zgjedhore të një çerdheje të sigurt të votuesve të një partie politike, ashtu që të mos fitojnë mandate në asnjërën prej tyre ose të fitojnë sa më pak. Çarja si mënyrë e realizimit të xherimanderingut është e mundur në dy llojet e njësive zgjedhore.

[15] “The First Gerrymander”. *Boston Gazette* (Boston), 15 April 1813, Vol. 38 No. 33. Në internet: https://www.bonhams.com/auctions/21962/lot/120/ (shikuar më 4 shtator 2022).

6. Sistemet zgjedhore (sistemi i shpërndarjes së mandateve)

Mënyra si funksionojnë format e qeverisjes në një vend ndikohet thellësisht nga faktorët ekstra juridik, ashtu që një pjesë bukur e madhe e organeve kushtetuese zhvillohet mbi bazën e rregullave të pashkruara të tipit normativ (**zakonet kushtetuese**) apo politik (**konventat kushtetuese**), që respektohen nga titullarët e organeve apo subjektet politike në një sistem. Në këtë kuptim, një rëndësi të madhe merr sistemi politik, i cili përbëhet nga tërësia e subjekteve që përfaqësojnë interesa shoqërore dhe që synojnë të marrin ose ndikojnë pushtetin politik. Në veçanti në shtetet demokratike, subjektet më të rëndësishme janë **partitë politike**, për të cilat diskutojmë në seksionet e fundit të këtij kapitulli, të cilat, duke pasur si qëllim marrjen e pushtetit ose drejtimin e qeverisë, duhet të ndërmjetësojnë mes përfaqësimit të interesave partiake dhe ruajtjes së unitetit nacional (shtetëror). Pa mohuar këtu rolin e faktorëve ekstra juridikë, përkatësisht të faktorëve sociologjikë, kur synojmë shpjegimin e ndikimit të sistemit politik në qeverisje (mjafton të përmendim funksionimin e ndryshëm të qeverisjes parlamentare në Britani të Madhe dhe Itali dhe qeverisjes semipresidenciale në Francë dhe Austri), atëherë natyra thellësisht juridike e konceptit të formës së qeverisjes përbën pikën e referimit për vlerësim të sistemit politik, partive politike dhe të vetë konceptit të fundit në këtë mes – **sistemit zgjedhor**. Ky i fundit, sistemi zgjedhor, shërben si një urë e fortë lidhëse në mes të formës së qeverisjes dhe sistemit politik, duke ndikuar si njërën ashtu edhe tjetrën dhe duke qenë edhe vetë e kushtëzuar nga to në rendimentin e vet praktik. Në këtë aspekt, sistemi zgjedhor në kuptimin e ngushtë nënkupton mbi të gjitha **formulën zgjedhore**, përkatësisht mekanizimin e transformimit të votave në mandate parlamentare.[16] Në kuptimin e gjerë, ndërkaq, ai paraqet tërësinë e procedurave dhe masave të cilat, të rregulluara me norma juridike të një vendi, kanë të bëjnë me zgjedhjet, përkatësisht me të drejtat zgjedhore (aktive dhe pasive), organizimin e zgjedhjeve, procedurën dhe teknikën e zgjedhjeve, ndarjen e mandateve, mbrojtjen e të drejtave zgjedhore dhe të ngjashme. Rëndësia e sistemit zgjedhor qëndron në atë se, në sistemin e demokracisë përfaqësuese, ato paraqesin mënyrën e formimit të organeve më të larta përfaqësuese në vend si dhe organeve të tjera të pushtetit të mesëm dhe të ulët. Themelet e tij përcaktohen me kushtetutë e më pas përpunohen me ligje të veçanta dhe akte nënligjore, me të cilat rregullohen zgjedhjet. Shprehja sistem zgjedhor, vlen të thuhet me këtë rast, nuk është një kategori kushtetuese apo ligjore, siç e ka vërejtur me të drejtë prof. Mijat Shukoviq, por një kategori teorike që e ka prodhuar doktrina e të drejtës kushtetuese.[17]

Pas konstatimit të rezultateve të zgjedhjeve, pason shpërndarja e mandateve apo konvertimi i votave në mandate, të cilat më pas shpërndahen sipas procedurës së përcaktuar ligjore dhe duke u bazuar në autorizimin kushtetues përkatës. Shpërndarja e mandateve reflekton vullnetin politik të votuesve. Për këtë arsye kjo përbën njërën ndër aspektet më të rëndësishme të **sistemit zgjedhor** dhe **demokracisë përfaqësuese** në përgjithësi. Ekzistojnë dy mënyra themelore të shndërrimit të votave në mandate: **sistemi mazhoritar** dhe **sistemi proporcional**.

Në sistemin mazhoritar mandatin e fiton kandidati që ka marrë më së shumti vota. Zgjedhjet sipas këtij sistemi kryhen në njësi të vogla zgjedhore në të cilat zgjidhet një deputet. Si përjashtim nga kjo mund të përmendet rasti i zgjedhjeve për president në SHBA, ku gati krejt elektorët (të përzgjedhurit që votojnë për president të SHBA-ve) zgjidhen në njësi të mëdha zgjedhore, në lista zgjedhore, sipas sistemit mazhoritar. Sistemi mazhoritar është më i vjetër se sistemi proporcional dhe përmes tij janë organizuar përzgjedhjet qysh në antikitet, Greqi dhe Romë (me kokrra/gogla).[18] Sipas përqindjes së votave të nevojshme për fitim të mandatit, dallohen **sistemi i shumicës absolute** dhe **sistemi i shumicës relative**.

---

16 Cf. Mauro Volpi, *Libertà e autorità. La classificazione delle forme di Stato e delle forme di governo.* Settima edizione (G. Giappichelli Editore: Torino, 2018), fq. 8-10.

17 Mijat Šuković, *Ustavno pravo* (CID: Podgorica, 2009), fq. 342 fusnota 58.

18 Cf. më shumë në E. S. Staveley, *Greek and Roman voting and elections* (Cornell University Press: Ithaca, N.Y., 1972), fq. 122, 133, 146, 148, 159, 224 etj.; Katz, Richard S. Katz, "Early Voting and Elections". Në *Democracy and Elections* (New York, 1997; online edn, Oxford Academic, 22 Sept. 2011). Në internet: https://doi.org/ 10.1093 / acprof:oso/9780195044294.003.0002 (shikuar më 14 tetor 2022).

Për të fituar mandatin në **sistemin e shumicës absolute** (sipas rregullit sistem më dy rrethe, balotazhi, nga frëngjishtja: **balotage**), nevojiten më shumë se gjysma e të gjitha votave, që do të thotë së paku 50% plus një votë. Në formën e butë, shumica absolute përcaktohet kundrejt numrit të votuesve, pra në raport me numrin e tërësishëm të votuesve që kanë votuar. Në formën e rreptë (rigoroze) të shumicës absolute, kërkohet mbi gjysma e votave të krejt votuesve të regjistruar në listat e zgjedhësve. Numri i votuesve të regjistruar çdo herë është më i madh se numri i qytetarëve që dalin në zgjedhje, sepse nuk dalin të gjithë në votim, ashtu që kjo shumicë absolute është më vështirë e arritshme. Për këtë arsye ky model nuk përdoren për zgjedhje por për format tjera të deklarimit të qytetarëve, ta zëmë, për referendume kushtetutëbërëse.

Zgjedhjet kryhen në rrethin e parë zgjedhor, nëse ndonjëri prej kandidatëve fiton shumicën e kërkuar. Më shpesh ndodhë që, në veçanti nëse ka më shumë kandidatë dhe votat shpërndahen, nuk arrihet shumica e kërkuar në rrethin e parë zgjedhor dhe organizohet rrethi i dytë. Me kalimin e kohës, zakonisht nga shtatë deri në katërmbëdhjetë ditë, votohet për dy kandidatët që kanë fituar më së shumti vota në rrethin e parë. Kandidati që fiton më së shumti vota, fiton mandatin. Për rrethin e dytë zgjedhor mund të ekzistojnë rregulla të ndryshme, si*ç* janë, ta zëmë: në të marrin pjesë tre kandidatë nga rrethi i parë (fiton ai që merr më së shumti vota); në të marrin pjesë të gjithë kandidatët nga rrethi i parë që kanë fituar një përqindje të caktuar të votave të hedhura (ta zëmë, 12.5 % në **Francë** për **Kuvendin Nacional**); në rrethin e dytë kërkohet dalja minimale në zgjedhje (50% nga krejt të regjistruarit me të drejtë vote).

Sistemit të shumicës absolute, përve*ç* nëse votohet sipas modelit preferencial, mund t'i bëhen vërejtje, sepse i lodhë votuesit me nevojën për të dalë në votime dy ose më shumë herë. Një numër i zgjedhësve as që mund të jetë më i interesuar për rrethin e dytë, sepse kandidati i tyre ka humbur në rrethin e parë. Dy këto arsye zvogëlojnë daljen në zgjedhje dhe, për rrjedhojë, legjitimitetin e kandidatit të zgjedhur. Sistemi zgjedhor me dy rrethe sjell krijimin e koalicioneve joparimore mes dy rretheve zgjedhore, gjë që shkakton ofendimin dhe hidhërimin e votuesve. Kjo nga shkaku se, në herën e dytë votohet për kandidatin sipas detyrës partiake, ani pse kandidati nuk ka qenë zgjedhja e votuesit. Për këtë arsye mund të ndodhë që zgjidhet kandidati me votat e atyre që në rrethin e parë kanë votuar kundër.

Për fitimin e mandatit në **sistemin e shumicës relative** (sistemi me një rreth, shumica relative), mjafton të fitohet numri më i madh i votave (**Britania e Madhe**, një pjesë e deputetëve në **Italia**, **Zelanda e Re** nga viti 1993 etj.). Këtu *ç*do gjë kryhet me një rreth zgjedhor, me fitoren e kandidatit që ka fituar më shumë vota, individualisht më shumë se secili kandidat tjetër. Është provuar se ky sistem shpesh *ç*on në krijimin gradual të sistemit politik dypartiak, në të cilin dy parti të mëdha politike ndërrohen reciprokisht në pushtet në mënyrë periodike. Sistemi i shumicës relative, me kalimin e kohës gjithashtu mënjanon ose largon partitë politike të **ideologjive ekstreme**, të cilat nuk mund të fitojnë mandate. Kjo *ç*on në stabilizim të sistemit politik dhe në krijimin, sipas rregullit, të qeverisë stabile njëpartiake. Një gjë e tillë mundësohet sepse, zakonisht, partia politike fituese, krejt e vetme, merr shumicën e mandateve në parlament. E meta themelore e **sistemit të shumicës relative** është marrëdhënia jo e saktë në mes të numrit të votave të fituara dhe mandateve. Partia politike fituese është e mbipërfaqësuar, sepse fiton joproporcionalisht më shumë mandate në raport me votat e fituara, kurse partitë tjera politike fitojnë më pak mandate sesa që u takojnë në bazë të votave të fituara. Partitë e vogla politike dhe grupet minoritare vështirë se fitojnë mandate, që do të thotë se parlamenti nuk reflekton pamjen apo peizazhin real politik të krejt shoqërisë.

Kanë qenë pikërisht kërkesat dhe synimet për arritjen e një raporti sa më të saktë në mes të numrit të votave dhe mandateve të fituara si dhe të një përfaqësimi sa më të gjerë të të gjitha opsioneve politike dhe grupeve shoqërore, ato që kanë *ç*uar te krijimi i **sistemit zgjedhor proporcional**. Kjo ka ndodhur në shek. XIX dhe lidhet me futjen e njësive sa më të mëdha zgjedhore ku do të votohet

për listat zgjedhore dhe zgjidhen më shumë deputetë. Në favor të sistemit proporcional theksohet fakti se parlamenti duhet të jetë trup përfaqësues i të gjithëve, diçka që mundësohet pikërisht dhe ekskluzivisht me vënien në jetë të sistemit proporcional. Tjetër argument në favor të këtij sistemi është që ai reflekton më me saktësi raportin në mes të votës së hedhur dhe mandateve të fituara në parlament, gjë që paraqet kushtin thelbësor të demokracisë së vërtetë. Për më tepër, për sistemin proporcional është thënë se përfaqëson zbulimin më të madh shoqëror.[19] Bazuar në këto argumente, sot ky sistem konsiderohet më i ndershëm, i saktë, i logjikshëm dhe i arsyeshëm, shkurt më i mirë se sistemi zgjedhor mazhoritar. Por, në praktikë, kjo nuk është kështu medoemos. Qeveria që del nga **shumica parlamentare**, thuajse çdo herë është qeveri koalicioni, potencialisht jostabile, e shantazhueshme nga kërkesat e anëtarëve të vegjël të koalicionit dhe në pamundësi për të funksionuar normalisht. Sistemi proporcional nxitë rritjen e numrit të partive politike, të cilat me lehtësi i fitojnë mandatet, edhe atëherë kur përfaqësojnë **ideologjitë ekstreme**. Për këtë arsye, në formë legjende, ekziston mendimi ndër politologë e konstitucionalistë se Partia Nacionalsocialiste e **Adolf Hitler** (Adolf Hitler: 1889-1945) kurrë nuk do të kishte hyrë në parlament në Gjermani, lëre më të bëhej parti parlamentare shumicë, sikur mos të ishte ndryshuar sistemi proporcional vaimarian i zgjedhjeve. Sistemi proporcional, për dallim nga ai mazhoritar, nuk është i zbatueshëm në zgjedhjet e drejtpërdrejta të **shefit të shtetit** apo **liderëve** të vetëqeverisjes lokale (vendore), por ekskluzivisht për zgjedhjet e trupave përfaqësues.

Në sistemet proporcionale ekziston një **instrument juridik**, me të cilin synohet pengimi i copëzimit (ndarjes) të tepruar të parlamentit që mund të krijohet si pasojë e fitimit të mandateve nga një numër i madh i partive politike, krahasuar me numrin e votave të tyre të marra në zgjedhje. E kemi fjalën për **pragun zgjedhor** të përcaktuar me ligj. Ky instrument mundëson eliminimin nga ndarja e mandateve ato lista zgjedhore që nuk kanë fituar një numër minimal përkatës të votave. Ky prag mund të nënkuptojë 1, 2, 3, 4, 5 e më shumë përqind të votave të hedhura. Në praktikë, megjithatë, kjo përqindje më së shpeshti është 5% (**Belgjika**, **Gjermania**, **Kroacia**, **Rusia**), por mund të shkojë deri në 10% (**Turqia**) apo edhe 3,25% (**Izraeli**). Nëse pragu është efikas, partitë politike motivohen për t'u bashkuar rreth një liste të përbashkët zgjedhore, në mënyrë që të arrijnë pragun më lehtë. Për këtë arsye formohen edhe lloj-lloj koalicionesh në formë karteli partiak, koalicione joparimore që fare nuk kanë të bëjnë me programet e partive politike dhe ideologjinë që përfaqësojnë ato. Kjo mund të pengohet përmes përcaktimit shkallor të pragut zgjedhor, kur ai është i ndryshëm në vartësi të asaj nëse bartës i listës është një parti politike, koalicion i dy, tri ose më shumë partive politike (Polonia: 5 deri 8%; Çekia: 5, 10, 15 dhe 20%; Rumunia: 5, 8, 9 dhe 10%). Nga pragu zgjedhor duhet dalluar **pragun natyror zgjedhor**: numri i votave, i shprehur në përqindje, që është i domosdoshëm për marrje apo fitim të një mandati (sikur mos të ekzistonte pragu zgjedhor). Kjo fitohet me pjesëtimin e numrit të tërësishëm të votave të hedhura me numrin e deputetëve që zgjidhen në njësi zgjedhore. Ky prag është i ndryshëm nga zgjedhjet në zgjedhje, rritet paralelisht me rritjen e numrit të votuesve që kanë dalë në zgjedhje dhe anasjelltas, dhe shërben si kategori përllogaritëse. Në raste të jashtëzakonshme, në njësi të vogla zgjedhore, kur ekzistojnë më shumë lista zgjedhore të ngelura nën pragun zgjedhor, **pragu natyror zgjedhor** mund të jetë më i lartë se **pragu zgjedhor**. Për listat zgjedhore të minoriteteve nacionale dhe minoriteteve të tjera, në vartësi të zgjidhjeve kushtetuese, në disa vende nuk kërkohet arritja e pragut zgjedhor, por vlen pragu natyror zgjedhor (ta zëmë, në Poloni, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut, Kosovë etj.).

Në disa vende evropiane janë bashkuar në mënyrë mekanike apo, thënë më mirë, janë **kombinuar** sistemi mazhoritar dhe sistemi proporcional (Gjermania, Hungaria, Italia, Spanja etj). Në **sistemin e përzier zgjed-**

[19] Në fakt, **Xh. S. Mill** nuk ka përdorur shprehjen proporcional fare. Nga përmbajtja e diskutimit të tij në kap. VII të librit të tij monumental mbi demokracinë përfaqësuese (1861) rrjedh se, megjithatë, ai ka folur për përfaqësimin e shumicës, jo të gjithëve, si reagim ndaj qëndrimeve të **Zhan Zhak Rusosë** *(*Jean-Jacques Rousseau: 1712-1778) mbi demokracinë dhe përfaqësimin e të gjithëve nga të gjithë. Cf. John Stuart Mill, *Consideration on Representative Government* (Cambridge University Press: Cambridge, 2011), Chapter VII: "Of True and False Democracy; Representation of All, and Representation of the Majority Only". Cf. edhe Dennis F. Thompson, *John Stuart Mill and Representative Government* (Princeton Legacy Library: Princeton, 1976); Jorge Urdánoz, "John Stuart Mill and proportional representation. A misunderstanding". *Political Science* Vol. 71 No. 2 (2019), fq. 158-171.

hor një numër i deputetëve zgjidhet individualisht, me sistemin mazhoritar, kurse pjesa tjetër e tyre zgjidhen në lista zgjedhore, me sistemin zgjedhor proporcional. Kjo qasje përbën njërën prej mënyrave të zbutjes së mangësive dhe vënies në dukje të përparësive të dy sistemeve në fjalë. Zgjidhje tjera ofrojnë për nga natyra e tyre sistemet e "vërteta" të përziera, ku kombinohen cilësitë themelore të sistemit mazhoritar dhe atij proporcional. Në një sistem të tillë të "vërtetë" të përzier ekzistojnë listat zgjedhore, që është karakteristikë e sistemit proporcional, kurse me votën tjetër votohet për individin (si votë alternative ose kumulative) nga lista zgjedhore. Për votuesin mesatar, në shumicën e vendeve, këto sisteme akoma konsiderohen mënyra të komplikuara të votimit. Mënyrat e tilla të ndryshme të votimit për deputet brenda një ose më shumë listave (vota e dytë), kombinuar me votimin për vetë listën, përkatësisht për partinë politike (vota e parë), krahas moduleve të **votimit preferencial** deri te **panashazhimi**, praktikisht janë të zbatueshëm vetëm aty ku niveli i arsimimit të votuesit mesatar është mjaft i madh (ta zëmë, Luksemburgu, Lihtenshtajni, Monako, Zvicra).

7. Llojet e sistemeve zgjedhore proporcionale

Në sistemet proporcionale, votat e hedhura shndërrohen në mandate përmes operacioneve matematikore. Ekzistojnë sistemet e kuotave (**kuota-Hare**, **kuota Hegenbah-Bishof, kuota Imperiali, kuota-Droop**), sistemet me koeficientin zgjedhor, sistemi i koeficientit më të madh zgjedhor (**metoda d'Hondt**) dhe sistemet e formulës matematikore (**formula Neimeyer**).

Kuota-Hare, krijues i së cilës është juristi britanik **Tomas Hare** (Thomas Hare: 1806-1891), përfaqëson sistemin fillestar të përllogaritjes së votave në mandate përmes kuotës zgjedhore. Quhet kuota e thjeshtë dhe nga kjo burojnë sistemet tjera me kuota. Numri i tërësishëm i votave të vlefshme të hedhura pjesëtohet me numrin e mandateve që fitohen në njësinë zgjedhore dhe fitohet lartësia apo kuota zgjedhore. Numri i votave të secilës njësi zgjedhore pjesëtohet me kuotën zgjedhore dhe fitohet numri i mandateve që ka fituar lista zgjedhore. Numri i mandateve është numri i tërësishëm, kurse numri decimal (pas presjes dhjetore) paraqet votat e mbetura. **Kuota-Hare** zbatohet në Austri (në zgjedhjet për njësitë federale), Brazil (pjesërisht).

Kuota Hegenbah-Bishof, e krijuar nga profesori zviceran, **Edvard Hagenbah Bishof** (Eduard Hagenbach-Bischoff: 1833-1910), përfaqëson kuotën e modifikuar Hare, ashtu që numri mandateve, që pjesëtohet me numrin e përgjithshëm të votave, rritet për një. Me këtë zvogëlohen mundësitë për ekzistimin e mandateve të pasistemuara. Zbatohet në **Greqi** dhe **Luksemburg**.

Kuota Imperiali, e krijuar nga politikani belg, **Pierr Gulliam Imperiali** (Pierre Guilliame Imperiali: 1874-1940), paraqet Kuotën-Hare të modifikuar, ashtu që numri i mandateve me të cilin pjesëtohet numri i tërësishëm i votave të vlefshme, rritet për dy. Me këtë rritje të pjesëtimit zvogëlohen mundësitë që ndonjë mandat të ngelet i pasistemuar. Në zbatim është në Ekuator, më herët në Itali, deri në vitin 1993, për Dhomën e Ulët të Parlamentit italian.

Kuota-Droop, e formuluar nga juristi e matematikani britanik, **Henri Ricmond Drup** (Henry Richmond Droop: 1831-1884), është një mbindërtim i kuotës së thjeshtë, ashtu që numri mandateve me të cilin pjesëtohet numri i përgjithshëm i votave të vlefshme rriten për një, dhe më pastaj edhe lartësia apo kuota e fituar rritet për një dhe fitohet kuota apo lartësia zgjedhore. Arsyet për këtë modifikim janë të njëjta si në rastin e kuotave apo lartësive paraprake. Zbatohet në **Irlandë** dhe në **Maltë**.

Vlen të theksohet se, në të gjitha këto sisteme, mund të ngelet pa u sistemuar ndonjë mandat. Më së shpeshti ai i ndahet listës zgjedhore e cila ka më së shumti vota të mbetura (numrin më të madh decimal). Mbetja e votave nga secila listë, nëpër të gjitha njësitë zgjedhore, mund të bartet në një listë (shtetërore) të përbashkët, për të cilën janë rezervuar një numër i caktuar i mandateve.

Sistemi zgjedhor më i vjetër, që nga viti 1882, dhe më i përfaqësuari në vendet evropiane është ai që bazohet në **metodën d'Hondt**, apo sistemi i kuotës më të lartë, të cilën e ka zbuluar profesori i së drejtës dhe matematikani belg, **Viktor d'Hondt** (Victor Joseph Auguste D'Hondt: 1841-1901). Ky sistem është shumë i thjeshtë: praktikisht nuk ka mundësi që të ngelen mandate të pasistemuara. Për shkak të faktit që zbatimi i kësaj metode nuk optimalizon cilësitë tjera të sistemit zgjedhor, në doktrinë është cilësuar si metodë më së paku proporcionale, pas **Kuota Imperiali**, dhe që favorizon partitë e mëdha.[20] Numri i votave që ka fituar secila listë zgjedhore (që ka kaluar pragun zgjedhor), ndahet me përpjesëtim sipas rrjedhës matematikore – një, dy, tre, deri te numri "**n**" që përfaqëson numrin e mandateve që zgjidhen (fitohen) në një njësi zgjedhore. Koeficientet e fituara sistemohen sipas madhësisë dhe mandatet i përkasin numrit "**n**" me koeficientin më të madh. Aq sa është koeficienti i listës zgjedhore brenda numrit "**n**" me koeficientin më të madh, aq mandate ka fituar. Zbatohet, në mes tjerash, në edhe në Argjentinë, Turqi, krahas vendeve të tjera evropiane, si Austria, Hungaria, Spanja etj.

Metoda Saint-Lague, e futur në përdorim nga **Andre Sant Lage** (André Sainte-Laguë: 1882-1950), matematikan francez, në fakt paraqet trajtë të modifikuar të **metodës d'Hondt**. Në vend të numrave një, dy, tre dhe kështu me radhë, ndarësit janë numra tek – një, tre, pesë dhe kështu me radhë, deri te numri **n** që përfaqëson numrin e mandateve që fitohen në njësinë zgjedhore. Në këtë sistem ka më shumë proporcionalitet se në **metodën d'Hondt**, që nënkupton se partitë e vogla politike kanë më shumë shansa për fitim të mandatit. Me një emër tjetër, **metoda Webster/Saint-Lague**, është sistem që përdoret në Bosnjë - Hercegovinë, në Gjermani për Dhomën e Lartë (Bundestag). Metoda Sain – Lague e modifikuar shfrytëzohet në Norvegji dhe Suedi (ndarësi më i vogël është 1,40 përkatësisht 20 dhe më pastaj shkohet me vazhdën e numrave tek – 3, 5, 7...).

Formula Neimeyer, që është zbuluar nga matematikani gjerman **Horst Nimajer** (Horst F. Niemeyer: 1931-2007), përfaqëson koeficientin e korrigjuar zgjedhor dhe quhet edhe metoda e mbetjes më të madhe. Numri mandateve të fituara përllogaritet ashtu që numri i deputetëve që zgjidhen në një njësi zgjedhore shumëzohet me numrin e votave që ka fituar lista konkrete zgjedhore. Produkti i fituar ndahet me numrin e votave të hedhura në njësinë zgjedhore (pa votat e hedhura të atyre listave zgjedhore që nuk kanë kaluar pragun). Koeficienti i fituar është numri i deputetëve që ka fituar lista zgjedhore. Numër decimal i koeficientit të fituar (pas presjes) janë votat e ngelura që mund të barten në listën e veçantë (shtetërore). Ose, nëse ka mandate të pasistemuara, votat e ngelura kësisoj mund t'ia sjellin listës edhe një mandat, nëse ngelja është mjaftueshëm e madhe. Kjo formulë është zbatuar në **Bundestagun** gjerman deri në vitin 2005.

8. Mbikëqyrja e zgjedhjeve, mbrojtja e të drejtave zgjedhore dhe sanksionet

Zgjedhjet janë mekanizëm i ndryshimit të pushtetit. Për këtë arsye është e rëndësishme që procesi zgjedhor të kontrollohet, si nga pjesëmarrësit ashtu edhe nga të tjerët, subjektet zgjedhore, në mënyrë që të shmangen keqpërdorimet eventuale. Kontrolli i zgjedhjeve, në të njëjtën kohë, është i lidhur me mbrojtjen e të drejtës zgjedhore, sepse me këtë sigurohet ligjshmëria e zgjedhjeve (dhe kushtetutshmëria në vendet që kanë kontrollin e kushtetutshmërisë së procesit zgjedhor, pa marrë parasysh nivelin). Kontrolli i zgjedhjeve, logjikisht, i paraprinë mbrojtjes së të drejtave zgjedhore.

8.1. Mbikëqyrja e zgjedhjeve

Kontrolli i zgjedhjeve përfshinë kontrollin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së procesit që normon zgjedhjet dhe, në veçanti, akteve dhe veprimeve juridike që ndërmerren në procedurën zgjedhore, nga

[20] Cf. më shumë në Robert G. Moser, "Electoral Systems and the Number of Parties in Postcommunist States". *World Politics* Vol. 51 No. 3 (Apr., 1999), fq. 359-384 (26 pages); Juraj Medzihorsky, "Rethinking the D'Hondt method". *Political Research Exchange* Vol. 1 Issue 1 (2019), fq. 1-15.

shpallja deri te përfundimi i zgjedhjeve. Kontrolli i parë mund të quhet **kontroll paraprak** dhe **preventiv**, para se të ndodh shkelja e të drejtës zgjedhore. Kontrolli i zgjedhjeve është i **mëpastajmë** dhe **represiv** kur kryhet, pasi të ketë ndodhur shkelja e të drejtës zgjedhore dhe ekziston nevoja për shqiptim dhe zbatim të sanksionit të caktuar.
Për kontroll të zgjedhjeve duhet të ekzistojnë dy palë, **kontrolluesi** dhe **i kontrolluari**, të cilët janë pjesëmarrës në zgjedhje. Si **pjesëmarrës në zgjedhje** konsiderohen: qytetarët si zgjedhës dhe kandidatët dhe propozuesit e kandidatëve, si*ç* janë: partitë politike dhe koalicionet, shoqatat e qytetarëve; organet për zbatimin e zgjedhjeve, siç janë: këshillat zgjedhore, këshillat dhe komisionet; dhe, së fundi, organet për mbrojtjen e të drejtës së zgjedhjes, siç janë: gjykatat dhe gjykata kushtetuese. Si **kontrollues** shfaqet subjekti që ka të drejtën e kontrollit të zgjedhjeve, kurse i **kontrolluar** është subjekti - aktet dhe veprimet e të cilit kontrollohen, siç janë: anëtari i organit zgjedhor apo pjesëmarrësi në zgjedhje. Objekt kontrolli mund të jenë edhe dispozitat mbi zgjedhjet. Subjektet e kontrollit potencialisht i ngërthejnë dy cilësitë: qytetari, ta zëmë, vepron në cilësinë e kontrolluesit kur mbikëqyrë punën e organit për zbatim të zgjedhjeve, kurse në cilësinë e të kontrolluarit kur veprimin e tij zgjedhor e kontrollon pjesëmarrësi tjetër në zgjedhje. Sipas subjekteve, ndërkaq, kontrolli mund të ndahet në **kontroll zyrtar**, të cilën e ushtrojnë organet zyrtare dhe trupat zgjedhore dhe **kontroll jozyrtar**, që kryhet nga ana e personave privat – votuesit, kandidatët dhe propozuesit e kandidatëve. Kushtet e përgjithshme që mundësojnë kontrollin e zgjedhjeve, të cilat duhet të jenë prezent *ç*do herë, kanë të bëjnë me sa vijon: publiciteti i procedurës zgjedhore dhe punës së organeve për zbatim të zgjedhjeve, e drejta e qasjes në materialin zgjedhor, e drejta e pjesëmarrjes në veprimet zgjedhore, informimi i mjaftueshëm i qytetarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në zgjedhje lidhur me zgjedhjet dhe të drejtat e tyre në to.

Një status të posa*ç*ëm juridiko-politik e kanë vëzhguesit e huaj. Ata nuk mund të iniciojnë procedurat për mbrojtjen e të drejtës së zgjedhjes, por ndikojnë në atë që rezultati i zgjedhjeve të pranohet nga të gjithë pjesëmarrësit në zgjedhje dhe nga bashkësia ndërkombëtare. Për këtë arsye një shfaqje e shpeshtë e vëzhguesve të huaj nëpër zgjedhje ka filluar në shtetet ku, për shkak të natyrës së regjimeve politike, kanë hasur në vështirësi për organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve të lira dhe demokratike. Zakonisht kjo lidhet me valën e parë të tranzicionit, si*ç* e ka thënë **Huan Linz** (Juan Linz: 1926-2013), kur u mbajtën zgjedhjet e para të lira dhe demokratike në ish-regjimet ushtarake në **Amerikën Latine** në vitet shtatëdhjetë të shek. XX (Kili, Panama, Paraguaj etj.). Më pas kjo ka ardhur në shprehje me ish-vendet komuniste në vendet e **Evropës Qendrore** dhe **Juglindore** në fund të shek. XX dhe rrënimin e regjimit të Aparteidit në **Afrikën e Jugut,** në kohën e njëjtë. Nga këto kohëra e tutje ka pasur prapë nevojë për konsolidim të demokracive në tranzicion të vendeve pa përvojë në organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve të lira dhe demokratike. Përtej kësaj situate, vëzhguesit e huaj sot janë prezent në zgjedhjet e shumë shteteve, me fillim nga Rusia, India, Japonia etj. dhe përfaqësojnë organizatat ndërkombëtare, siç janë: OKB, OSBE, Këshilli i Evropës (KE), Unioni Afrikan (UA), Bashkimi Evropian (BE), organizatat joqeveritare dhe shtetet e huaja në emër të të cilëve veprojnë përfaqësuesit diplomatiko-konsullor, delegacionet parlamentare dhe përfaqësuesit e organeve zgjedhore. Të gjithë vëzhguesit e huaj në zgjedhje duhet të lajmërohen zyrtarisht dhe të marrin akreditimin për një gjë të tillë, të cilin e japin organet për zbatimin e zgjedhjeve që lëshojnë leje të posaçme për këtë qëllim (akredidivat). Këto leje ua mundësojnë vëzhguesve që pa pengesa të përcjellin procesin zgjedhor. Në disa shtete ndalohet me ligj vëzhgimi i zgjedhjeve nga vëzhgues të huaj (në **SHBA** ka filluar lejimi i vëzhgimit të zgjedhjeve nga vëzhguesit ndërkombëtarë vetëm pas vitit 1990, kur u nxorën **Karta e Parisit** dhe **Dokumenti i Kopenhagës**, me të cilën shtetet anëtare të **OSBE** u zotuan se do të ftojnë vëzhguesit ndërkombëtare për monitorimin e zgjedhjeve në vendet e tyre; në **SHBA** monitorimi i parë ka ndodhur në vitin 2002).[21]

[21] Susan D. Hyde, "The U.S. election is over. What did international observers think?" *The Washington Post* November 9, 2020. at 6:16 a.m. EST. Në internet: https://www.washingtonpost.com/politics/2020/11/09/us-election-is-over-what-did-international-observers-think/ (shikuar më 6 shtator 2022).

8.2. Mbrojtja e të drejtës së zgjedhjes dhe sanksionet

Me mbrojtjen e të drejtës së zgjedhjes mbyllet realizimi i institutit të së drejtës së zgjedhjes. Të drejtën për mbrojtjen e të drejtave zgjedhore e garanton kushtetuta. Ajo është ngushtësisht e lidhur me parimet dhe të drejtat tjera kushtetuese, siç janë: ndarja dhe balancimi i pushteteve dhe pavarësia e gjyqësorit, kushtetutshmëria dhe ligjshmëria, zbatueshmëria e drejtpërdrejtë e dispozitave kushtetuese mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, kontrolli gjyqësor i administratës, barazia para ligjit, e drejta për mjet juridik. Pa mbrojtjen e garantuar do të ekzistonte rreziku që të drejtat zgjedhore të ngelnin një deklarim kushtetues pa përmbajtje, realizimi i të cilave do të varej nga vullneti politik i pushtetit.

Mbrojtja e të drejtave zgjedhore mund të shihet më gjerësisht, si mbrojtje nga shkelja e dispozitave zgjedhore në krejt procedurën zgjedhore dhe ngushtësisht, si mbrojtje e të drejtave zgjedhore gjatë vetë votimit. Me cenimin e të drejtave zgjedhore gjatë votimit nuk shkelen vetëm dispozitat që normojnë zgjedhjet por edhe të tjerat, siç janë ligji penal dhe i kundërvajtjes, ligji mbi rendin dhe qetësinë publike.

Qëllimi përfundimtar i mbrojtjes së të drejtës së zgjedhjes është zbatimi i ligjshmërisë së zgjedhjes, kurse qëllimi konkret ka të bëjë me ruajtjen dhe kultivimin e mundësisë që secili individ lirshëm të shpreh vullnetin e vet politik të vërtetë, duke votuar ashtu siç dëshiron.

Autorizimin për mbrojtjen e të drejtave zgjedhore e kanë para së gjithash qytetarët, në cilësinë e votuesit dhe të kandidatit. Propozuesit e kandidatëve gjithashtu kanë të drejtën e kësaj të drejte dhe e iniciojnë në emër të votuesve, kandidatëve ose në emër të tyre. Instrumentet juridike që i shërbejnë kësaj mbrojtjeje janë: prapësimi (kundërshtimi), peticioni zgjedhor, ankesa, padia, ankesa kushtetuese, kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë. Prapësimi paraqitet në organin e shkallës së parë, komisionit zgjedhor, kurse ankesa organit të shkallës së dytë – komisionit qendror zgjedhor ose gjykatës. Padia i drejtohet gjykatës, kurse mbi ankesën kushtetuese dhe kushtetutshmërinë vendos gjykata kushtetuese. Karakteristikë e procedurës për mbrojtjen e të drejtave zgjedhore është se janë **afatet e shkurtra** për paraqitjen parashtresave dhe vendosjes, kurse instrumentet juridike si më sipër duhet të jenë efektiv dhe pa pagesë. Afatet për paraqitje dhe vendosje zakonisht llogariten me orë – 12, 24, 48 etj.

Në fillim, organi që ka vendosur për mbrojtjen e të drejtës së zgjedhjes dhe në përgjithësi lidhur me ligjshmërinë e zgjedhjeve, ka qenë parlamenti. Nga rregulli që vetë parlamenti vendos për ligjshmërinë e zgjedhjeve, ka mbetur vetëm e drejta e tij për verifikim apo vërtetim të mandateve të deputetëve.

Sot, kryesisht është gjykata ajo që vendos për mbrojtjen e të drejtës së zgjedhjes, gjë që paraqet një efekt refleksiv të **parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve**. Kjo është logjike, për shkak se gjykata kujdeset për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, kurse e drejta e zgjedhjes është njëra prej më të rëndësishmëve. Organet e mbrojtjes së zgjedhjes janë edhe komisionet zgjedhore, këshillat dhe komisionet, si trupa që realizojnë zgjedhjet. Ato vendosin mbi mbrojtjen e të drejtës së zgjedhjes duke zbatuar rregullat e procedurës administrative, si organe të shkallës së parë dhe shkallës së dytë, e më pas aktivizohet gjykata, si kontrollues i ligjshmërisë së punës së administratës dhe si një organ i mbrojtjes përfundimtare të së drejtës zgjedhore.

Janë të ndryshme gjykatat që mbrojnë të drejtat zgjedhore dhe zgjidhin kontestet zgjedhore: gjykatat e kompetencës së përgjithshme (**SHBA**), gjykatat administrative si gjykata të kompetencës së posaçme (Çekia), gjykatat kushtetuese (**Afrika e Jugut**, **Austria**, **Brazili**, **Meksiko** etj). Këto të fundit në disa vende kanë kompetenca mjaft të gjëra dhe përmbajtësore, siç është rasti me Francën, ku një kompetencë mjaft të gjerë në zgjidhjen e kontesteve zgjedhore e ka **Këshilli Kushtetues i Francës** (KKFr), i cili vendos edhe mbi shpalljen e rezultateve përfundimtare për President të Republikës.

Mbrojtja e të drejtave zgjedhore nënkupton **eliminimin e shkeljes** së këtyre të drejtave, përkatësisht sanksionimin e cenimit të ligjshmërisë së zgjedhjeve. Nëse konstatohet se janë shkelur të drejtat zgjedhore dhe ligji, atëherë duhet të urdhërohet përsëritja e zgjedhjeve në vendvotim, njësi zgjedhore dhe, në rast të shkeljeve masive të të drejtave zgjedhore dhe ligjit, atëherë përsëriten krejt zgjedhjet.

Nëse në veprimin e shkeljes së të drejtave zgjedhore dhe ligjit janë gjetur elemente të veprës penale apo kundërvajtjes, atëherë do të shqiptohen sanksione penale ose kundërvajtëse nga ana e gjykatës. Vepër tipike penale zgjedhore është **falsifikimi i rezultateve zgjedhore**. Forma më e rëndë e veprave penale zgjedhore ekziston atëherë kur kryhet nga personat që janë anëtarë të organeve për zbatimin e zgjedhjeve dhe mbrojtjen e të drejtave zgjedhore. Kundërvajtjes janë formë më e butë e veprës së dënueshme, siç janë, ta zëmë: prishja e rendit dhe qetësisë publike në vendvotim, prishja e heshtjes zgjedhore, krijimi mundësisë për votim pa dokumentacion të vlefshëm etj. **Sanksionet** që i shqiptohen kryesit të veprës penale janë dënimi me të holla, dënime me burg dhe humbja e të drejtës së zgjedhjes për një kohë të caktuar.

Një formë e veçantë e veprimit të ndëshkueshëm është shkelja e rregullave gjatë fushatës zgjedhore. Këtë e bëjnë mediat kur nuk iu përmbahen rregullativës që normon kohën dhe vendin e prezantimit të kandidatëve, kohëzgjatjen e spoteve zgjedhore, ndalimin e fushatës negative. Sanksionet i shqipton trupi që përcjell fushatën zgjedhore, këshilli i medias, komisioni zgjedhor, gjykata kushtetuese; ato konsistojnë në dënime me të holla dhe ndalimin e vazhdimit të shkeljeve të rregullave që normojnë zgjedhjet. Në rastet e skajshme, për shkak të shkeljes së rregullave gjatë fushatës mund të vije edhe deri te anulimi i kandidaturës në zgjedhjet e dhëna.

9. Zgjedhjet në Kosovë

9.1. Pasqyrë e zgjedhjeve të deritanishme parlamentare

Më 2 korrik 1990, Kuvendi i Kosovës ka miratuar **Deklaratën për Kosovën si njësi konstitutive Jugosllavisë**, me të cilën synohej arritja e statusit të barabartë të vendit me njësitë federale të ish-Jugosllavisë, e cila atëbotë ishte futur në një krizë serioze që çoi në shpërbërjen e saj të dhunshme (1990-1992). Në fakt, procesi zyrtar i shpërbërjes, sipas dokumentit juridik-ndërkombëtar, i prodhuar nga trupi i njohur si **Komisioni Badinter**, që ka funksionuar në kuadër të Konferencës për ish-Jugosllavinë, ka nisur në shtator të vitit 1991 dhe ka përfunduar në verë të vitit 1992.[22]

[22] Në fillim kur ka nisur kriza ish-jugosllave, që rrezikonte stabilitetin dhe paqen në Evropë, BE ka iniciuar bisedimet paqësore dhe ka themeluar një trup formal institucional, i njohur si **Konferenca për Jugosllavinë**, e cila pas mbylljes së procesit të shpërbërjes në verë të vitit 1992, është cilësuar si Konferenca për ish-Jugosllavinë. Në kuadër të kësaj konference ka funksionuar tërë kohën një komision juridik, për të zgjidhur të gjitha çështjet kontestuese juridiko – politike me karakter kushtetues dhe ndërkombëtar lidhur me ish-Jugosllavinë. Gjatë punës së tij (fundi vitit 1991 deri në mesin e vitit 1993), **Komisioni Badinter** ka dhënë gjithsejtë 15 mendime.Mendimi i parë është nxjerrë më 29 nëntor 1991 dhe ka konstatuar se procesi i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë ka filluar në shtator të vitit 1991 (kur u mbajtën referendumet për pavarësi të ish-republikave jugosllave, tani shtete sovrane dhe të pavarura). Mendimi nr. 8 i datës 4 korrik 1992 ka konstatuar se procesi i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë ka përfunduar më 27 prill të vitit 1992 (me shpalljen e pavarësisë së Jugosllavisë Federative, të përbërë nga Serbia dhe Mali i Zi, e njohur edhe si Jugosllavia e Millosheviqit). Cf. për tekstin e plotë të pesëmbëdhjetë mendimeve, në: Opinion No. 1., *International Legal Materials,* 31 (1992), p. 1494; Opinion No. 2, ibid., p. 1497; Opinion No. 3, ibid., p. 1499; Opinion No, 4, ibid., p. 1501; Opinion No. 5, ibid., p. 1503; Opinion No. 6, ibid., p. 1507; Opinion No. 7, ibid., p. 1512; Opinion No, 8, ibid., p. 1521; Opinion No, 9, ibid., p. 1523; Opinion No, 10, ibid., p. 1525; Opinion No. II, ibid., p. 1586; Opinion No. 12, ibid., p. 1589; Opinion No. 13., ibid., p. 1591; Opinion No. 14, ibid., p. 1593; dhe Opinion No. 15, ibid., p. 1595. Për komente të shkëlqyera dhe literaturë shteruese për kohën, cf. më shumë në Matthew C. R. Craven, "The European Community Arbitration Commission on Yugoslavia" *British Yearbook of International Law*, Volume 66, Issue 1 (1995), fq. 333–413.

Ky dokument i **Kuvendit të Kosovës** gjerësisht njihet si **Deklarata e 2 korrikut**. Sa i përket natyrës së saj juridike, ndërkaq, ajo paraqet një deklaratë tipike kushtetuese, siç e thotë edhe vetë autori i saj, tani më i ndjerë, akademik **Gazmend Zajmi** (1936-1995). Me këtë dokument është bërë, siç e ka thënë vetë autori i saj, shtrati juridik historik i pavarësisë së Kosovës.[23] Kjo është kështu sepse me të nuk është shpallur Kosova shtet sovran dhe i pavarur, por vetëm si një njësi e barabartë me të tjerët në ish-Jugosllavi. Deri atëherë, Kosova ka qenë pjesë përbërëse e **Republikës së Serbisë**, e cila ka qenë njësi federale sikur republikat tjera ish-jugosllave. Kosova, megjithatë, në këtë kohë ka gëzuar një autonomi të gjerë, e njohur si autonomi politiko-territoriale, por pa qenë element konstituiv i ish-Jugosllavisë komuniste si ish-republikat tjera. Për këtë arsye edhe vetë **Deklarata e 2 korrikut**, në titullin e saj e thekson synimin e vendit për të qenë i barabartë me tjerët.[24] Në këtë frymë, pra zgjidhje e statusit të entitetit dhe kombit të barabartë brenda ish-Jugosllavisë, janë nxjerrë edhe dokumentet implementuese të saj: **Kushtetuta e Kaçanikut** (7 shtator 1990), **Ligji Kushtetues për zbatimin e Kushtetutës së Kaçanikut** (7 shtator 1990), **Ligji zgjedhor** (7 shtator 1990) dhe **Ligji për bashkimin e qytetarëve në parti politike, shoqata dhe forma të tjera të bashkimit**.[25]

Kosova ka ndjekur rrugën e republikave ish-jugosllave në veri, të cilat në vitin paraprak kishin miratuar dokumentet e tyre me rëndësi kushtetuese e shtetërore, që kanë kulmuar me shpalljen e pavarësisë së plotë nga ish-Jugosllavia.[26] Pikërisht për arsye, **Kushtetuta e Kaçanikut** në fillim kishte kërkuar zgjidhje të statusit të Kosovës, bazuar në Deklaratën e 2 korrikut, brenda ish-Jugosllavisë. Shkëputja e Kroacisë e Sllovenisë në ndërkohë kishte ndryshuar rrënjësisht qëndrimin dhe përllogaritjen e lidershipit kosovar. Duke u mbështetur në modelin kroat dhe slloven, më 22 shtator 1991, **Kuvendi i Kosovës** miratoi **Rezolutën për Pavarësi dhe Sovranitet**.[27] Në vijim të implementimit të këtij dokumenti sublim, dhe në frymën e veprimeve të njëjta të njësive federale ish-jugosllave, nga 26 deri më 30 shtator 1991 u mbajt **referendumi për pavarësinë**, në të cilin morën pjesë 914,802 votues, 99.98% e të cilëve votuan pro pavarësisë.[28] Numri total i qytetarëve me të drejtë vote në Kosovë në këtë kohë llogaritej të ishte 1,051,357.[29] Bazuar në rezultatet e **referendumit**, Kosova deklaroi pavarësinë më 19 tetor 1991 dhe bëri ndryshimin e **Kushtetutës së Kaçanikut**, duke ia përshtatur në tërësi rrethanave dhe modelit të shteteve sovrane dhe të pavarura në tërësi, siç ishin Kroacia, Sllovenia, por edhe republikat tjera ish-jugosllave. Ky deklarim i pavarësisë nuk u pranua ndërkombëtarisht për shkak se strukturat e pushtetit paralel në Kosovë ushtronin pushtet moral, jo pushtet politik, duke mos qenë nën

---

23 Skënder Skënderi, *Si veproi Kuvendi i Republikës së Kosovës*. *Vëllimi I-rë* (Priting press: Prishtinë, 2016) fq. 400.

24 Cf. më shumë për këtë në librin e shkëlqyer të autorit kosovar, doajenit të së drejtës kushtetuese në Kosovë, prof. dr. Kurtesh Salihu, *Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e autonomitetit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në Jugosllavinë Socialiste* (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës: Prishtinë, 1984).

25 Skender Skenderi, *Si veproi Kuvendi i Republikës së Kosovës*. *Vëllimi I-rë,* fq. 404-407.

26 **Bosnje-Hercegovina** ka mbajtur referendumin për pavarësi e sovranitet nga 29 shkurt deri më 1 mars 1992. 66.3 për qind e votuesve kanë marrë pjesë në zgjedhje, kurse 93 për qind e tyre kanë qenë pro pavarësisë së vendit. Më 6 mars 1992, **Parlamenti i Bosnje Hercegovinës** ka miratuar rezultatet e referendumit, kurse dita 1 mars 1992 ngelet si ditë kur është krijuar shteti i Bosnje-Hercegovinës; **Kroacia** ka shpallur pavarësinë më 15 qershor 1991, pak pas referendumit të 19 majit 1991 ku qytetarët votuan masivisht për pavarësi (83 për qind e votuesve kanë dal në zgjedhje, kurse 93 për qind kanë votuar pro pavarësisë); **Maqedonia e Veriut** më 8 shtator 1991; **Sllovenia** ka mbajtur referendumin për pavarësi më 26 dhjetor 1990. Në te kanë marrë pjesë 90 për qind e votuesve, kurse 93 për qind e tyre kanë votuar pro pavarësisë; zyrtarisht, ndërkaq, **Sllovenia** ka shpallur pavarësinë më 25 qershor 1991, me të cilin është konstituuar si shtet sovran dhe i pavarur ndërkombëtarisht; së fundi, **Republika Federale e Jugosllavisë** (Serbi – Mali i Zi) është themeluar më 27 prill 1992.Krejt këto data janë konfirmuar ndërkombëtarisht si data të krijimit të këtyre shteteve, pas shpërbërjes së tërësishme të ish-Jugosllavisë si shtet, që u krijua më 1918 dhe u zhduk më 27 prill 1992, duke lënë pas fillimisht pesë shtete (**Bosnje-Hercegovina**, **Kroacia, Maqedonia Veriut**, **Sllovenia** dhe **Republika Federale e Jugosllavisë**). Kosova është shtet i fundit, që nuk ka lindur më 1992 kur u prish ish-**Jugosllavia**, por më 17 shkurt 2008, duke u shkëputur nga Serbia. Cf. më shumë për rastet e ish-republikave jugosllave dhe kohën kur ato kanë trashëguar ish-Jugosllavinë (që është moment tjetër nga dita e shpalljes së tyre shtete sovrane dhe të pavarura) në Matthew C. R. Craven, "The European Community Arbitration Commission on Yugoslavia", fq. 354-409.

27 Miranda Vickers, ***Between Serb and Albanian**: **A History of Kosovo*** **(Columbia University Press: New York, 1998), fq. 251.**

28 Ibid., fq. 251-252.

29 Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS), *Abetarja e pushtetit: Libërth mbi politikën, njerëzit dhe partitë në Kosovë* (Prishtinë, dhjetor 2011), fq. 28. Ne internet: https://cupdf.com/document/abetarja-e-pushtetit-librth-mbi-politikn-njerzit-ishte-situata-politike.html?page=1 (shikuar më 18 shtator 2022).

kontrollin efektiv të territorit të Kosovës dhe popullsisë së saj.[30] Ajo ngeli si një akt me fuqi mobilizuese të jashtëzakonshme për liderët dhe popullin e Kosovës, në dimensionin e vet të brendshëm kushtetues dhe politik, deri në momentin e çlirimit përfundimtar të vendit më 10 qershor 1999 nga **Ushtria Çlirimtare e Kosovës** (UÇK), e cila u ndihmua fuqishëm nga trupat e NATO-s.
Në periudhën e Kosovës komuniste, deri më 2 korrik 1990 e njohur me emrin **Krahina Socialiste Autonome e Kosovës** (KSAK), në kuadër të Serbisë dhe -Jugosllavisë komuniste, nuk ka ekzistuar një sistem zgjedhor demokratik, por i a.q. **sistemi i delegimit**, pra sistemi ku qytetarët, sipas standardeve komuniste, përzgjedhin ata që do të zgjedhin të tjerët, jo për t'i përfaqësuar zgjedhësit, por të zgjedhurit (delegatët), të cilët, në të njëjtën kohë, përfaqësonin interesat e larta socialiste të regjimit komunist jugosllav.[31]

Me **Ligjin zgjedhor** të 7 shtatorit 1990, në hartimin e të cilit ka marrë pjesë autori i parë i këtij libri, së bashku me profesorin e ndjerë **Fehmi Agani** (1932-1999) dhe juristin e mirënjohur kosovar të së drejtës administrative dhe kushtetuese, zt. **Lazim Salihu**, për herë të parë kanë qenë të vëna kushtet për realizimin e të drejtës aktive dhe pasive të zgjedhjes, votimin e drejtpërdrejtë, njësitë zgjedhore, kandidimin uninominal në sistemin zgjedhor të shumicës relative dhe çështje të tjera të së drejtës zgjedhore. Ky ligj ka qenë përpunim i materies së zgjedhjeve, e cila për herë të parë u bë materie kushtetuese me **Kushtetutën e Kaçanikut**, të cilën ky ligj e ka implementuar sa i përket organizimit dhe mbajtjes së zgjedhjeve. Zgjedhjet e para të lira dhe demokratike në **Kosovë**, në bazë të këtij ligji, janë mbajtur më 24 maj 1992, si ato presidenciale ashtu edhe ato parlamentare. **Ibrahim Rugova** (1944-2006) ishte kandidati i vetëm në zgjedhjet presidenciale. Në zgjedhjet parlamentare morën pjesë rreth 490 kandidatë nga 22 parti politike, si dhe disa kandidatë të pavarur. **Lidhja Demokratike e Kosovës** (LDK) fitoi zgjedhjet me 76.44%. Tri parti të vogla fituan rreth 27 ulëse, kandidatët e pavarur i fituan dy ulëse dhe 14 ulëse mbetën të zbrazëta pasi që serbët dhe malazezët e bojkotuan procesin zgjedhor. Në ndërkohë, parlamenti i zgjedhur në vitin 1992 nuk u mblodh asnjëherë dhe nuk miratoi asnjë ligj. Polica serbe kishte parandaluar përpjekjen e vetme për t'u mbledhur. Presidenti i Kosovës kështu ishte figura e vetme legjitime. Në njërën anë, shteti serb e udhëhiqte Kosovën, derisa në anën tjetër, ajo ekzistonte si demokraci, të paktën në letër. [32]

Përkundër okupimit brutal nën regjimin e diktatorit serb **Sllobodan Millosheviq** (Slobodan Milošević: 1941-2006), që zgjati deri më 10 qershor 1999 kur u çlirua falë luftës heroike të popullit shqiptar nën udhëheqjen e **UÇK** dhe ndërhyrjes ushtarake të NATO-së, Kosova zhvilloi një jetë politike plurale dhe një demokraci të brendshme për lakmi. Sistemi zgjedhor që u ndërtua pas rënies së komunizmit dhe futjes së vendit nën okupimin serb nuk ka qenë statik, por ka kërkuar zgjidhje të reja dhe inovative. Në këtë kuptim, përzgjedhja e sistemit zgjedhor mazhoritar në fillim, me Ligjin zgjedhor të 7 shtatorit 1990, ka qenë rezultat i pluralizmit të dobët në Kosovë, ku **LDK-ja**, realisht posedonte tiparet e një lëvizje nacionale të shqiptarëve të Kosovës, kurse partitë tjera kanë qenë shumë margjinale dhe pa ndonjë ndikim të prekshëm.[33] Motivet politike kanë qenë vendimtare edhe për kalim në sistemin zgjedhor proporcional, pas luftës, sepse autoritetet e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, administrata ndërkombëtare e njohur si **UNMIK**, kishin interes që **Kuvendi i Kosovës**, nën mbikëqyrjen e tyre, të kishte sa më shumë ndarje në baza politike, etnike, gjuhësore, fetare dhe baza të tjera. Nga kjo daton **demokracia konsociacionale kosovare**, një demokraci e imponuar nga **UNMIK**.[34] Veçoritë kryesore të sistemit zgjedhor në kohën e UNMIK-ut

[30] Cf. më shumë në Enver Hasani "Self-Determination under the Terms of the 2002 Union Agreement Between Serbia and Montenegro: Tracing the Origins of Kosovo's Self-Determination. *Chicago-Kent Law Review*, Vol. 80, No. 1 (2005), fq. 305-329 në fq. 313, fusnota 34 (ku autorët e huaj të së drejtës ndërkombëtare japin arsye të njëjta për mosnjohje të Kosovës si shtet Sovran dhe i pavarur).

[31] Mbi sistemin e delegimit dhe në përgjithësi përgjegjësinë në sistemin komunist ish-jugosllav, cf. më shumë në Esat Stavileci, *Odgovornost u samoupravnom društvu* (Pokrajinski centar za marksističko obrazovanje: Priština, 1977); Esat Stavileci, *Shteti, vetqeverisja dhe sistemi i delegimit: përvoja dhe praktika* (Flaka e vëllazërimit: Shkup, 1978).

[32] Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS), *Abetarja e pushtetit: Libërth mbi politikën, njerëzit dhe partitë në Kosovë*, fq. 28-30.

[33] Skender Skenderi, *Si veproi Kuvendi i Republikës së Kosovës*. *Vëllimi I*-rë (autori, si ish-deputet i Kuvendit të Kosovës që shpalli **Deklaratën e 2 korrikut** dhe **Kushtetutën e Kaçanikut**, dëshmon se krejt aktiviteti shtetëror kosovar në vitet e para ka ndodhur nën ombrellën e LDK dhe liderit të saj të ndjerë Dr. **Ibrahim Rugova**; Cf. për vlerësim të njëjtë edhe në Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS), *Abetarja e pushtetit: Libërth mbi politikën, njerëzit dhe partitë në Kosovë*, fq. 28-32.

[34] Cf. më shumë për këtë në Adem Beha, "Consociational Democracy and Political Engineering in Postwar Kosovo"

kanë qenë konsistente. Zgjedhja e **sistemit proporcional** nga UNMIK-u, si sistemi më i përshtatshëm, kishte parasysh situatën në periudhën e pasluftës dhe ndarjet shoqërore: në vendet me potencial për konflikt, asnjë parti nuk duhet të mbetet me më pak ulëse se sa përqindja e rezultatit zgjedhor që ka fituar. Një **sistem proporcional**, që në mënyrë rigoroze i shndërron përqindjet në ulëse u pa si një zgjedhje e mençur dhe e drejtë që parandalon konfliktin potencial mes shqiptarëve dhe serbëve. Historia e zgjedhjeve në Kosovën e pas 10 qershorit 1999 nis me vitin 2000. Më 28 tetor të atij viti u mbajtën zgjedhjet e para për kuvendet komunale. Një vit më pas, më 17 nëntor 2001, u mbajtën gjithashtu për herë të parë, zgjedhjen për Kuvendin e Kosovës.

Deri në shpalljen e pavarësisë së vendit më 17 shkurt 2008, në Kosovë janë mbajtur edhe dy palë **zgjedhje komunale** (26 tetor 2002 dhe 17 nëntor 2002) dhe dy palë të tjera për **Kuvendin e Kosovës** (23 tetor 2004 dhe 17 nëntor 2007), të gjitha nën patronatin e **UNMIK-ut**. Në vitin 2003, një fushatë e madhe e shoqërisë civile çoi në përdorimin e **listave të hapura** dhe **në zgjedhjen e drejtpërdrejtë të kryetarëve të komunave**, që u përdor për herë të parë në vitin 2007. Avokimi për zonat zgjedhore dështoi kundrejt rezistencës së madhe politike. Si një hap prapa, e njëjta valë e ndryshimeve solli një prag të lartë zgjedhor që kishte për synim krijimin e koalicioneve qeverisëse stabile. Futja në përdorim e **listave të hapura** pa zona zgjedhore e vështirësoi votimin. Në mënyrë që fletëvotimi të mos arrinte madhësinë e një libri (110 emra për secilën parti), emrat u publikuan në një libërth të veçantë, që vendosej në çdo kabinë votimi. Efekti tjetër anësor i një zone të vetme zgjedhore me **lista të hapura** ishte rreziku që emrat e partisë që gjendeshin në pjesën e sipërme të listës të përfitonin padrejtësisht nga radhitja. Për të parandaluar një dominim të emrave të kreut të listës garuese, **OSBE**-ja loboi me sukses që të përdorej vota preferenciale. Çdo votues në fillim duhej ta gjente partinë e preferuar dhe pastaj t'i identifikonte deri në dhjetë emra në listën prej 110 emrash dhe t'i shënonte numrat gjegjës në fletëvotim.[35] Vlen të theksohet se, në zgjedhjet e para të pas luftës, **Kosova** kishte më pak se **një milion votues**, dukshëm më pak se popullsia e para-luftës. Shumë prej banorëve të Kosovës nuk ishin kthyer pas luftës, ndërsa serbët refuzonin të regjistroheshin. Rritja e stërmadhe e **listës së votuesve** (LV), me 37%, përkatësisht 5,6% në dy vitet pasuese, mund të shpjegohet vetëm me regjistrimin e shpejtë të diasporës së Kosovës, kthimin e të zhvendosurve dhe klimën e përmirësuar mes serbëve të Kosovës.[36]

Sistemi zgjedhor i instaluar nga **UNMIK-u**, pak a shumë është ruajtur, në thelb, edhe pas pavarësimit të vendit më 17 shkurt të vitit 2008. Deri në momentin e shkrimit të këtyre rreshtave (shtator 2022), në Kosovë ka pasur zgjedhje të përgjithshme në vitet si vijon: 2010, 2014, 2017, 2019 dhe 2021. Zgjedhje lokale, ndërkaq, ka pasur në vitet sa vijon: 2009, 2013, 2017 dhe 2021.[37]

Karakteristikat kryesore të sistemit zgjedhor të dizajnuar nga **UNMIK-u** në vitin 2000, i shtjelluar si më sipër, kanë qenë për sa vijon:

- në rastin e zgjedhjeve për kuvende (si për kuvende komunale ashtu dhe për Kuvend të Kosovës) ka pasur sistem proporcional të përfaqësimit me formulë favorizuese për partitë politike të mesme ose të vogla, ndërsa në rastin e zgjedhjeve për kryetar komune është përdorur sistemi mazhoritar;
- legjislacioni zgjedhor ka qenë mjaft përfshirës edhe për sa i përket elektoratit edhe subjekteve politike të cilat kanë garuar për zgjedhje dhe programeve të votimit që kanë lehtësuar ushtrimin e së drejtës së votës, si dhe në parapëlqimin e sistemit të votimit preferencial;

Nationalities Papers Vol. 47 No. 4 (July 2019), fq. 674-689.

35 Instituti Demokracia për zhvillim, *Trendet zgjedhore 2000-2014. Analizë numerike e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit* (Prishtinë, 2015), fq. 10-12. Në internet: https://d4d-ks.org/ëp-content/uploads/2015/07/D4D_ ELECTIONS_9 _ Trendet_Zgjedhore_2000-2014_SHQ_-web.pdf (shikuar më 18 shtator 2022).

36 Ibid., fq. 16.

37 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, *Trendet zgjedhore në Republikën e* Kosovës. Më shumë së një dekadë në statistika zgjedhore (Prishtinë, 2022), fq. 19-20. Në këtë material janë dhënë të gjitha modalitetet e zgjedhësve, lloji votuesit dhe numri tyre, fituesit dhe humbësit, dalja në zgjedhje dhe çdo gjë tjetër që lidhet me zgjedhjet në Republikën e Kosovës. Në internet: http://www.kqz-ks.org/ (shikuar më 20 shtator 2022).

- ideja për promovimin e gjinisë më pak të përfaqësuar në proces (veçanërisht si kandidatë dhe përfaqësues të zgjedhur) ka qenë e pranishme që nga fillimi;
- komunitetet joshumicë kanë pasur trajtim të posaçëm në formë të ulëseve të veçanta të siguruara dhe rregullave të ndarjes së ulëseve sipas preferencës;
- gjatë kësaj periudhe, struktura e administratës zgjedhore ka treguar përmirësim të vazhdueshëm;
- sa u përket elementeve të sistemit zgjedhor, mund të përmendim, mes tjerash, përdorimin e përkohshëm të sistemit me lista të mbyllura, futja e pragut ligjor për subjektet politike që përfaqësojnë komunitetin shumicë, heqja votimit në mungesë, dhe gjithashtu edhe përpilimi dhe ndërtimi i regjistrit të votuesve, ndryshimet në pushtetin e regjistrimit të partisë politike, ndryshimet në përbërjen e organeve menaxhuese zgjedhore, ndryshimin në sistemin e mjeteve juridike etj.[38]

Për zgjedhjet e anëtarëve të kuvendeve (qofshin komunale apo për Kuvend të Kosovës), **Kosova** ka përdorur një sistem të listave të partive me përfaqësim proporcional, gjegjësisht sistemin e koeficientit më të lartë me përdorim të metodës **Sainte-Lague**, e cila edhe pas shpalljes së pavarësisë mbetet e vlefshme. Në këtë metodë të ndarjes së ulëseve, numri gjithsej i fletëvotimeve të vlefshme për secilin subjekt politik që garon në zgjedhje pjesëtohet sipas numrave vijues tek (1, 3, 5, 7, 9 etj.) për të nxjerrë koeficientin. Koeficientet më të lartë (p.sh. 120 më të lartët në renditje në rastin e Kuvendit të Kosovës), përcaktojnë numrin e ulëseve për secilin subjekt dhe renditjen se si ndahen ato.

Krahas votimit për subjektin politik, me tri përjashtime (2001, 2002, 2004), votuesit kanë mundur të votojnë kandidatin e tyre të preferuar në fletëvotim (**listë e hapur**) dhe renditja përfundimtare e kandidateve realizohet në renditje nga fundi i votave preferenciale për kandidatët por duke e marrë parasysh kërkesën gjinore. Kjo ka ndryshuar pas shpalljes së pavarësisë: që nga viti 2009, për zgjedhjen e anëtareve të kuvendeve komunale, është zbatuar **një variant special i sistemit të listës së hapur**: votuesi nuk mund t'ia jep votën preferenciale udhëheqësit të listës, por vetëm për kandidatët tjerë, ndërkohë që udhëheqësi i listës konsiderohet të ketë marre **votën preferenciale me automatizëm**. Në rastin e sistemit me listë të mbyllur, që ishte në fuqi para shpalljes së pavarësisë dhe u sqarua më sipër, votuesi nuk mund të jep votën preferenciale dhe kandidatët marrin mandatin në renditjen e përcaktuar nga subjekti politik para zgjedhjeve.

Sa u përket zgjedhjeve për deputetë të Kuvendit, Kosova ka qenë një zonë e vetme zgjedhore (të gjithë votuesit marrin nga një fletëvotim të njëjtë). Kjo është kështu edhe sot. Për zgjedhjet për anëtarë të kuvendeve komunale, situata është e njëjtë si para shpalljes së pavarësisë: komuna përbën një zonë të vetme zgjedhore. Që nga viti 2007, subjektet politike të shqiptarëve të Kosovës të cilat garojnë në zgjedhje për Kuvend të Kosovës është dashur të fitojnë së paku 5% të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme për të marrë pjesë në ndarjen e ulëseve, situatë që akoma ngelet e njëjtë edhe pas shpalljes së pavarësisë (**pragu zgjedhor**). Për zgjedhjet e kuvendeve komunale, nuk ka pasur prag zgjedhor, njëjtë sikur sot.

Nga viti 2000, nën kushte të ndryshme, komuniteteve joshumicë u janë ndarë ulëse në Kuvendin e Kosovës, nga 20 sosh në çdo Kuvend. Sistemi i **ulëseve të rezervuara**, i përdorur deri në vitin 2010, subjekteve politike të komuniteteve joshumicë u jepte ulëse krahas ulëseve të fituara në mënyrë të rregullt në garën zgjedhore. U mor vesh, nëse komunitetet në fjalë fitonin ulëse të tilla me votë të vlefshme, krahas **ulëseve të garantuara**. Këto ulëse janë prodhuar nga votat për të cilat është kryer votimi, pa marrë parasysh numrin e tyre. Nëse komunitetet joshumicë kanë arritur të fitojnë vota mbi pragun ligjor, atëherë votat përtej atij pragu kanë shkuar për ulëset e rezervuara. Deri në vitin 2010 kanë ekzistuar dy sisteme, kur janë anuluar ulëset e rezervuara. Nga viti 2014 e deri më sot ekziston vetëm sistemi i **ulëseve të garantuara**, që nënkupton se komunitetet joshumicë garojnë kryesisht për këtë numër ulësesh, që fitohet pa marrë parasysh numrin e votave të fituara: ulësja fitohet sipas shumicës relative të votave të vlefshme të fituara (**pragu natyror**).
Për zgjedhjet për kryetar komune, që nga 2007 është përdorur një **sistem zgjedhor mazhoritar**, i njohur

[38] Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, *Zgjedhjet në Kosovë 2000-2014* (KQZ: Prishtinë, 2017), fq. 9-20. Në internet: www.kqz-ks.org (shikuar më 20 shtator 2022).

si "sistemi me dy raunde": për t'u zgjedhur, kandidati duhet të fitojë më shumë se gjysmën e votave të vlefshme dhe, nëse kjo nuk arrihet gjatë raundit te parë, atëherë mbahet një raund i dytë ndërmjet kandidateve që kanë marrë numrin më të lartë të votave gjatë raundit të parë. Kjo ngelet kështu edhe sot e kësaj dite. **Kuotat gjinore në listat e partive** janë zbatuar për listën e kandidatëve të partive politike nga viti 2000. Kjo kuotë ka qenë 33%, për sa i përket 67% të kandidatëve të parë në listën e kandidatëve nga viti 2001 deri në 2004. Ndërkaq, 30%, për sa i përket numrit të përgjithshëm të kandidatëve të emëruar (apo për sa i përket 15 kandidatëve të parë vetëm në vitin 2000) në rastin e zgjedhjeve të tjera. **Kuota gjinore për rezultate**, ndërkaq, është aplikuar nga viti 2001 e tutje, dhe ajo aplikohet vetëm për zgjedhjet për Kuvend të Kosovës dhe për kuvende komunale. Nuk ka pasur **kuota për listat e partive** apo për **rezultate për zgjedhje** për kryetar komune.

9.2. Llojet e zgjedhjeve, burimet dhe e drejta zgjedhore

Aktualisht në **Republikën e Kosovës** ekzistojnë dy lloje të zgjedhjeve të drejtpërdrejta, për dy nivele të pushtetit. Në nivel republikan ekzistojnë vetëm zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, kurse në nivel të mesëm, nuk ekzistojnë zgjedhje sepse Kosova është shtet unitar. Në nivelin kosovar, zgjedhjet rregullohen me **Ligji nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës** (më tutje Ligji nr. 03/L-073),[39] i cili ka zëvendësuar **Rregulloren e UNMIK-ur nr. 2004/12 mbi zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës**, datë 5 maj 2004, që ka vlejtur deri në organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve të fundit para shpalljes së pavarësisë, përkatësisht zgjedhjet e 17 nëntorit 2007. Në nivel lokal (vendor) ekzistojnë zgjedhjet për këshilltarë komunalë dhe për kryetarin e komunës. Këto zgjedhje rregullohen me **Ligjin nr. 03/L-072 për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës** (më tutje Ligji nr. 03/L-072), i cili ka zëvendësuar **Rregulloren e UNMIK nr. 2000/39 mbi zgjedhjet komunale në Kosovë**, datë 8 korrik 2000.

E drejta zgjedhore në Kosovë rregullohet me Kushtetutën e Kosovës, e cila vë bazat juridike të sistemit zgjedhor në Kosovë, ligjet e mësipërme për zgjedhjet e përgjithshme dhe zgjedhjet lokale, si dhe me aktet përkatëse nënligjore që kryesisht i nxjerr **Komisioni Qendror Zgjedhor** (KQZ) por edhe organet në nivel qendror dhe lokal. Këto së bashku normojnë dy nivelet e zgjedhjeve në Kosovë. Kushtetuta normon disa çështje të së **drejtës zgjedhore materiale**: kushtet për fitimin e të drejtës së zgjedhjes (aktive dhe pasive), numri deputetëve, kohëzgjatja e mandatit, cilësitë e të drejtës së zgjedhjes (e përgjithshme dhe e barabartë), natyrën e zgjedhjeve (të lira dhe të drejtpërdrejta), cilësitë e të drejtës së votës (e fshehtë dhe personale), natyrën e mandatit të deputetit (jo i detyrueshëm). Dy ligjet si më sipër për zgjedhjet më tutje specifikojnë këto kategori materiale kushtetuese të së drejtës zgjedhore. Si ligj tjetër i rëndësishëm për të drejtën zgjedhore është edhe **Ligji për shtetësinë**,[40] i cili ka zëvendësuar **Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/13 për Regjistrin Qendror Civil**, si dhe **Ligji për gjendjen civile**,[41] që së bashku normojnë regjistrin unik civil të personave me shtetësi kosovare që kanë vendbanim në Kosovë. Për pasojë, dy ligjet janë të vlefshëm edhe për zgjedhjet e dy niveleve. Krahas këtyre burimeve ekzistojnë edhe aktet nënligjore, siç janë: vendimet e Kuvendit të Kosovës, udhëzimet, rregulloret dhe rregullat tjera të **KQZ-së** dhe komisioneve lokale zgjedhore, vendimet dhe rekomandimet e ministrive përkatëse (të financave, drejtësisë, punëve të brendshme, vetëqeverisjes lokale dhe administratës publike) dhe **Komisionit të Pavarur të Mediave** (KPM). Në aktet nënligjore më të rëndësishme hyjnë **rregullat zgjedhore**, me të cilat subjektet zgjedhore dhe qytetarët udhëzohen mbi mënyrën e zbatimin e zgjedhjeve. Ato janë njëzetenjë gjithsej, miratohen nga **KQZ-ja** dhe përmbajnë dispozita të detajuara lidhur me vetë procedurën zgjedhore, duke u nisur nga rregullat mbi regjistrimin e partive politike e deri te ato mbi certifikimin e rezultateve zgjedhore.[42]

---

[39] Ligji nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*/ Prishtinë: VITI III/Nr. 31/15 qershor 2008.

[40] Neni 31.1 i **Ligjit nr. 04/L-215 për shtetësinë e Kosovës**. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*/ Nr. 33/ 2 shtator 2013, Prishtinë.

[41] **Ligji nr. 04/L-003 për gjendjen civile**. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*/Nr. 6/22 korrik 2011, Prishtinë.

[42] Në ueb faqen e **KQZ**, aktualisht (20 shtator 2002) figurojnë këto **rregulla zgjedhore** (sipas numrave dhe vitit të nxjerrjes së tyre): mbi regjistrimin dhe veprimin e partive politike; krijimin, konfirmimin dhe sfidimin e listës së votuesve; votimin jashtë Kosovës; votimin e personave me nevoja dhe rrethana të veçanta; kutitë postare dhe komunikimin elektronik me subjektet

Krahas këtyre **burimeve primare të së drejtës zgjedhore**, mund të përmendim edhe disa burime subsidiare të kësaj pjese të së drejtës kushtetuese, por që normojnë fusha të tjera të së drejtës. E kemi fjalën për **burimet subsidiare të së drejtës zgjedhore**, si vijon: **Ligji mbi procedurën e përgjithshme administrative** (Ligji Nr. 05/L -031),[43] me të cilin pjesërisht rregullohet puna e organeve për zbatimin e zgjedhjeve (që sipas rregullit janë organe të administratës); **Kodi Penal** (Kodi nr. 06/L-074),[44] që normon veprat penale kundër zgjedhjeve; **Kodi Procedurës Penale** (Kodi nr. 08/L-032),[45] që normon procedurën penale në përgjithësi, e në veçanti edhe për këtë lloj të veprave penale, u mor vesh pa e specifikuar një gjë të tillë; **Ligji për kundërvajtjet** (**Ligji nr. 05/L-087**),[46] që normon procedurën për dënim për kundërvajtje lidhur me zgjedhjet, **Ligji për Gjykatën Kushtetuese** (**Ligji nr. 03/L-121**),[47] me të cilin normohet kompetenca dhe procedura e Gjykatës Kushtetuese për vendosje mbi ankesat kushtetuese lidhur me shkeljet e të drejtave zgjedhore, por vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet e rregullta juridike që ofron sistemi juridik i Kosovës. Deri me ndryshimet dhe plotësimet e **Ligji nr. 03/L-073** të vitit 2010, **certifikimi i zgjedhjeve** nuk ka mund të bëhet pa u kryer procedurat e nisura në **Gjykatën Kushtetuese**.[48] Tani kjo dispozitë më nuk ekziston dhe certifikimi bëhet nga **KQZ-ja**, kurse procedurat eventuale sipas ankesës në Gjykatën Kushtetuese vazhdojnë rrugën e tyre sipas rregullave të brendshme të këtij institucioni.

E drejta aktive dhe pasive e zgjedhjes në Kosovë është e barabartë për të gjithë, nën kushte të njëjta dhe njëjtë për të gjitha llojet e zgjedhjeve. Me **Kushtetutën e Kosovës** garantohet se çdo shtetas madhor, me aftësi veprimi, ka të drejtë të zgjedh dhe të zgjidhet (neni 45.1). Për të votuar në zgjedhje, Përveç moshës madhore (18 vjeç), aftësisë së veprimit (shëndetit mendor) dhe shtetësisë, nevojitet edhe pasja e vendbanimit në Kosovë dhe regjistrimi në listën unike zgjedhore. Përveç këtyre, për të drejtën pasive të zgjedhjes, domosdo duhet të plotësohen kushtet e mbështetjes së kandidaturës, të cilat janë të ndryshme për dy nivelet e zgjedhjeve. Kjo e drejtë kushtetuese, që operacionalizohet me **Ligji nr. 03/L-073** dhe akte të tjera nënligjore të **KQZ-së**, mund të merret ose kufizohet vetëm me vendim të gjykatës kompetente.

9.3. Elementet themelore të sistemit zgjedhor

Në Kosovë sot ekziston sistemi proporcional i zgjedhjeve që garantohet me Kushtetutë dhe tutje specifikohet me **Ligji nr. 03/L-073**. Krejt **Kosova** është një njësi e vetme zgjedhore, kurse listat zgjedhore janë të hapura. Në zgjedhjet pas luftës, sistemi proporcional ka qenë i njëjtë sikur sot, por me lista të mbyllura. Pragu zgjedhor është pesë përqind dhe për herë të parë është futur, sikundër u tha, në zgjedhjet e organizuara nga UNMIK-u në vitin 2007. Në nivel lokal, një njësi zgjedhore e përbën komuna. Presidenti nuk zgjidhet drejtpërdrejt por në Kuvendin e Kosovës, për këtë arsye, për zgjedhjen e tij nuk vlejnë dispozitat e **Ligji nr. 03/L-073**. Për pasojë, as ne nuk e diskutojmë në këtë vend por në pjesën në vijim, pjesën e katërt, në pjesën që flet për **Presidentin e Republikës**.

---

politike; qendrën e numrimit dhe rezultateve; vëzhguesit e zgjedhjeve; certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve; votimin, numërimin në vendvotim dhe menaxhimin e qendrave të votimit; raundin e dytë të votimeve për kryetar të komunave; kodin e mirësjelljes së subjektëve politike, mbështetësve të tyre dhe kandidatëve; kufizimin e shpenzimeve të fushatës dhe deklarimi financiar; fushatën zgjedhore dhe njoftimin për ngjarjet politike; financimin e subjekteve politike dhe sanksionet; zgjedhjet e jashtëzakonshme dhe parakohshme; themelimin e qendrave të vtimit; periudhën e shërbimit të votuesve për ndërrimin e qendrave të votimit; emrimin, përbërjen dhe funksionimin e komusioneve komunale zgjedhore; këshillat e vendvotimit; fletëvotimet dhe broshurat; dhe rezultatet preliminare.

43 **Ligji nr. Nr. 05/L -031 për procedurën e përgjithshme administrative**. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*/Nr. 20/21 qershor 2015, Prishtinë.

44 **Kodi nr. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës**. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*/ Nr. 2/14 janar 2019, Prishtinë.

45 **Kodi nr. 08/L-032 i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës**. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*/ Nr. 24/17 gusht 2022, Prishtinë.

46 **Ligji nr. 05/L-087 për kundërvajtje**. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*/Nr. 33/3 shtator 2016, Prishtinë.

47 **Ligji nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës**. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*/ Nr. 45/ 15 janar 2009, Prishtinë.

48 Neni 6 i **Ligjit nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.** *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*/ Nr. 87/16 nëntor 2010, Prishtinë.

Sistemi zgjedhor me një njësi zgjedhore, përfshirë Kosovën, shikuar nga këndi i barazisë së të drejtës për votë, duket më i ndershmi, sepse lista zgjedhore që fiton votë më shumë se tjetra, proporcionalisht me këtë merr mandate më shumë. Për të gjitha listat, pragu është pesë përqind i votave të fituara nga krejt numri i votuesve që kanë votuar, pra, **pragu** nuk është vetëm relativ, por edhe absolut. Kjo, megjithatë, nuk vlen për komunitetet pakicë. Sikundër u tha më sipër, nga viti 2000, nën kushte të ndryshme, komuniteteve joshumicë u janë ndarë ulëse në Kuvendin e Kosovës, nga 20 sosh në çdo Kuvend: deri në vitin 2010 kanë ekzistuar **ulëset e rezervuara**, ku subjektet politike të komuniteteve joshumicë fitonin ulëse krahas ulëseve të fituara në mënyrë të rregullt në garën zgjedhore (nëse fitonin të tilla); pas këtij viti janë anuluar **ulëset e rezervuara**, me amendamentet kushtetuese të shtatorit 2010 me të cilat u mbyll pavarësia e mbikëqyrur. Aktualisht ekziston vetëm sistemi i **ulëseve te garantuara**, i aplikuar që nga viti 2014, që nënkupton se komunitetet joshumicë garojnë kryesisht njëzet ulëse, sipas sistemit të shumicës relative të krejt votave të vlefshme të hedhura në kuti të votimit.

Nisur nga fakti se numri i votuesve është shumë i madh, kandidatët nuk njihen në krejt vendin. Për pasojë, kryesisht votohet për partinë politike dhe kryetarin e saj, ngaqë emrat e kandidatëve fort nuk kanë rëndësi. Kjo do të thotë se, praktikisht votuesi nuk e ka lirinë e zgjedhjes së përfaqësuesit të vet, por këtë e bartë në partinë politike, duke ndryshuar kështu karakterin e drejtpërdrejtë të zgjedhjeve. Kjo logjikë bartet edhe në Kuvendin e Kosovës, të cilin e përbëjnë kryesisht përfaqësues anonim pa bazë të tyren zgjedhore dhe, për pasojë, pa përgjegjësi politike ndaj votuesit. I përgjigjen vetëm partisë së tyre politike: gjatë mandatit, deputeti praktikisht është përfaqësues i partisë së vet, kurse përfaqësues i qytetarit vetëm në kuptim abstrakt, gjë që vërtetohet me votimin e disiplinuar mbi baza partiake të deputetëve. Nga kjo rrjedh se qytetarët për deputetin janë më pak të rëndësishëm, se partia të cilës i takojnë. Kjo është kështu sepse ata, pra votuesit, edhe në zgjedhjet e radhës orientohen sipas partisë politike dhe liderit të tyre. Në instancë të fundit, kjo bën që qytetari sovranitetin e vet ta bartë në parti politike, jo në organin përfaqësues.[49] Një gjë e tillë, por në një masë më pak të theksuar, vlen edhe për nivelin tjetër të zgjedhjeve – nivelin lokal (vendor). Këtu njësi zgjedhore shfaqet komuna.

Listat krejtësisht të mbyllura ngushtojnë mundësinë e partisë politike, duke reduktuar atë eksklузivisht në fuqinë e nominimit gjatë fazës së përpilimit të listës. Kandidatët që rangohen më lartë në listë, fitojnë mandatet. Kjo shtron dilemën pse të kandidohet duhet të futen në listë dhe të marrin pjesë në fushatë zgjedhore kur rangimi ata që kanë rangim të ulët kanë gjasa vetëm teorike për të fituar mandatin. E njëjta vlen edhe për këshilltarët komunalë në zgjedhjet lokale (vendore).

Mandati i lirë i deputetit nënkupton që ai vetë është pronar i tij dhe disponon me të. Kjo u jep mundësi deputetëve që të ndërrojnë anën partiake dhe, për pasojë, vullnetin zgjedhor të qytetarëve. Edhe partia politike që fare nuk ka marrë pjesë në zgjedhje (ta zëmë, nuk ka ekzistuar kohë më parë), mund të fitojë mandate dhe në këtë mënyrë të bëhet parti parlamentare. Nëse votuesit kanë votuar vërtetë për partinë politike, atëherë rrjedh që në këtë sistem, me një njësi zgjedhore (veçanërisht kur edhe listat janë të mbyllura) nuk është në harmoni me natyrën e mandatit të lirë politik.

Edhe këshilltarët lokalë posedojnë lirshëm me mandatet e tyre, gjë që mund të veje deri te ndryshimi i lojaliteteve politike ndaj partisë që i ka kandiduar ata. Në të vërtetë, kjo ndodhë mjaft shpesh në zgjedhjet lokale sepse ndryshimi i shpejtë i anëve sjell në pushtet më shpejt ata që kanë humbur me votën e lirë. Numri i këshilltarëve lokalë caktohet me **Ligjin nr. 03/L-040** për vetëqeverisjen lokale

[49] Për rolin e madh të partive politike në formësimin e vullnetit politik, përfshirë ish vendet komuniste, cf. më shumë në Paul G. Lewis, *Political Parties in Post-Communist Eastern Europe* (Routledge: London and New York, 2000); Rosa Mule, *Political Parties, Games and Redistribution* (Cambridge University Press: Cambridge, 2004); Norman Schofield and Itai Sened, *Multiparty Democracy. Elections and Legislative Politics* (Cambridge University Press: Cambridge, 2006).

(më tej shkurt: Ligji nr. 03/L-040).[50] Numri i anëtarëve në kuvendin e komunës të një komune duhet të jetë proporcional, varësisht nga numri i qytetarëve në komunë. Ai numër ndryshon, nga 15 deri në 41 anëtarë, me përjashtim të **Komunës së Prishtinës**, e cila ka 51 këshilltarë.

Qëllimi i pragut zgjedhor të përcaktuar me nenin 112 (a) të **Ligjit nr. 03/L-073**, është që të pengojë dromcimin (thërrmimin) e skenës politike, veçanërisht përbërjen e Kuvendit të Kosovës, në shumë parti të vogla dhe jo të përhershme. Pragu, megjithatë, ka mundësuar që Kuvendi, në aspektin partiak, të jetë mjaft i thërrmuar, në secilën legjislaturë deri më sot. Kështu, ta zëmë, në legjislaturën e tetë, që është legjislatura aktuale në kohën e shkrimit të këtyre rreshtave (20 shtator 2022), **Kuvendi Kosovës** përbëhet prej 13 partive politike dhe koalicioneve. Kjo gjendje mbretëron sepse partitë e vogla politike hyjnë në Kuvend përmes listët së koalicioneve, bartës i së cilës është partia e madhe, për të cilën vlen pragu i njëjtë si për listën me një parti. Për deputetë të tillë të zgjedhur nga partitë e vogla, shtrohet pyetja lidhur me ekzistimin e legjitimitetit të tyre – përkrahjes popullore. Pikërisht për këtë, më e arsyeshme do të kishte qenë që listat e koalicioneve të dy e më shumë partive të kishin një prag ligjor më ta lartë se 5%, në pajtim me numrin e partive që paraqesin listën zgjedhore. Pragu zgjedhor i njëjtë është edhe për zgjedhjet lokale, përkatësisht për zgjedhjet e këshilltarëve në kuvendet komunale.

Për listat zgjedhore të partive politike të komuniteteve joshumicë në Kosovë nuk ekziston pragu zgjedhor, ata hyjnë në Kuvendin e Kosovës nëse arrijnë **pragun zgjedhor natyror**.[51] Se kush përfaqëson komunitetet, këtë e ka përcaktuar Kushtetuta e Kosovës në nenin e saj 64.2, së bashku me definimin e komuniteteve të Kosovës (neni 57.1). Çertifikimi i subjekteve politike nga neni 15 i **Ligjit nr.03/L-073** është i njëjtë për të gjitha partitë, kurse për komunitetet joshumicë, ligjvënësi kosovar ka përdorur një standard shumë gjeneroz që operacionalizon nenin 64.2 të Kushtetutës: "Çdo subjekt politik në kërkesën e tij tregon nëse dëshiron të hyjë në garë për të fituar ndonjërin prej vendeve të garantuara për përfaqësim të serbëve dhe komuniteteve tjera joshumicë të Kosovës, sipas nenit 64 të Kushtetutës", thuhet në paragrafin 11 të nenit 15 të **Ligjit nr. 03/L-073**. Kjo është, në të njëjtën kohë. Pjesë përbërëse e **demokracisë konsociacionale kosovare.** Ky kusht formal në praktikë mund të testohet fare lehtë, përkatësisht përkatësia një komuniteti joshumicë kosovar, në bazë të kritereve të tjera objektive: siç janë vendbanimi i gjatë në një vend, gjuha, religjioni, krahas deklarimit subjektiv të një personi që regjistrohet në regjistrat përkatës civilë. Kjo është korrekte edhe në aspektin kushtetues, sepse vetë neni 57.1 si më sipër përdor kritere objektive për definim të komuniteteve të Kosovës.[52]

Në Kosovë, sikundër u tha më sipër, që nga paslufta zbatohet **metoda Saint-Lague** e llogaritjes dhe shndërrimit të votave në mandate. Numri i përgjithshëm i votave të vlefshme të fituara nga secili subjekt politik në zgjedhjet për Kuvend pjesëtohet me 1, 3, 5, 7, 9, 11, 13, 15, e kështu me radhë derisa numri i pjesëtuesve të shfrytëzuar t'i përgjigjet numrit të plotë të vendeve. [53] Koeficientet që rezultojnë nga vargu i pjesëtimeve rregullohen në renditje zbritëse. Vendet u ndahen subjekteve politike sipas koeficienteve në mënyrë që vendi i parë i takon subjektit që e ka koeficientin më të madh, vendi i dytë subjektit që e ka koeficientin e radhës më të madh, e kështu me radhë derisa të ndahen të gjitha vendet.[54] Nëse një subjekti politik i ndahen vende që janë baras me numrin e kandidatëve në listën e tij dhe ka

[50] **Ligji nr. 03/L-040** për vetëqeverisjen lokale. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*/Prishtinë: VITI III/Nr. 28/4 qershor 2008.

[51] 111.3 i **Ligjit nr. 03/L-073**:
"Njëzet (20) vendet e rezervuara në Kuvend të përshkruara në pikën (b) të paragrafit 1 të këtij neni u ndahen subjekteve politike që përfaqësojnë komunitetin serb dhe komunitetet tjera joshumicë në Kosovë sipas mënyrës së njëjtë të përshkruar në nenin 112.2 të këtij ligji, në bazë të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme të fituara nga secili subjekt politik, pavarësisht nga numri i vendeve tashmë të ndara prej njëqind (100) vendeve".

[52] Neni 57.1 i **Kushtetutës së Kosovës**:
"Banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës (Komunitetet), gëzojnë të drejta të veçanta, të përcaktuara me këtë Kushtetutë, krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të përcaktuara në Kapitullin II të kësaj Kushtetute.

[53] Neni 112 (b) i **Ligjit nr.03/L-073**.

[54] Neni 112 (c) i **Ligjit nr.03/L-073**.

ende vende për të ndarë, atëherë pjesa e mbetur e koeficientit të atij subjekti nuk merret parasysh gjatë ndarjes së vendeve të mbetura. Koeficientet pasues me renditje zbritëse përdoren derisa të ndahen të gjitha vendet.[55] Nëse ndodh barazimi për shkak se dy ose më shumë koeficientë janë të njëjtë, vendi ndahet me hedhje të shortit nga kryesuesi i **KQZ**-së, në praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve politike në fjalë.[56] Sipas kësaj metode, siç mund të shihet, praktikisht nuk mund të ekzistojnë mandate të pasistemuara, sepse vetëm teorikisht ka mundësi që dy lista zgjedhore të kenë koeficientin e njëjtë të radhitjes (rangimit).

Në **listën e votuesve** evidentohen qytetarët që kanë të drejtën e zgjedhjes – shtetasit e moshës madhore me vendbanim në Kosovë. Ekziston një **regjistër qendror civil** për krejt shtetin, që udhëhiqet sipas dispozitave të **Ligjit mbi shtetësinë** dhe **Ligjin nr. 03/L-073** dhe nga i cili nxirren ekstraktet për nevojat e zgjedhjeve. Në ndërkohë që regjistrin qendror civil e udhëheq organi kompetent shtetëror, ministria kompetente për punët e administratës, **listën e votuesve** e mban KQZ-ja, e cila duhet ët jetë e saktë dhe e përditësuar. Lista votuesve përmban, në rend të parë, ekstraktin më të vonë në dispozicion nga **regjistri qendror civil** i të gjithë votuesve me të drejtë vote të cilët janë regjistruar si qytetarë të Kosovës sipas **Ligjit për shtetësinë**. Regjistri qendror civil pajis KQZ-në me të gjitha informatat përkatëse që KQZ kërkon për të mirëmbajtur Listën e Votuesve në pajtim më afatet kohore të caktuara nga KQZ-ja.[57] Në listën e votuesve futen edhe të miturit që ditën e votimit mbushin moshën madhore. Lista votuesve mirëmbahet rregullisht si një bankë elektronike e të dhënave, kurse ndryshimet në të bëhen në bazë të vendimit të organeve kompetente. Ndryshimet në listën e votuesve mund të futen edhe sipas kërkesës së qytetarëve, gjithashtu në bazë të vendimit të organit kompetent. Pas shpalljes së datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Kosovës, Sekretariati i KQZ-së e bën listën e votuesve të disponueshme në zyrat e komisioneve komunale të zgjedhjeve në secilën komunë, sikurse është përcaktuar me rregullat e KQZ-së dhe në pajtim me rregullat për mbrojtjen e të dhënave. Përveç kësaj, komisionet komunale të zgjedhjeve mund të përcaktojnë lokacione shtesë për të publikuar lista e votuesve kur kjo është e nevojshme për të siguruar qasje në të brenda komunës së saj. Mbështetur në rekomandimet e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve, KQZ-ja, përmes Sekretariatit të KQZ-së, jo më vonë se dyzet (40) ditë para zgjedhjeve, i publikon lokacionet e sakta të të gjitha qendrave të votimit. KQZ-ja vërteton se lista e votuesve është në përputhje me ligjin në fuqi.[58]

Kontrollin e zgjedhjeve e kryejnë komisionet zgjedhore - respektivisht KQZ dhe komisionet komunale të zgjedhjeve - si dhe këshillat e vendvotimeve.[59] Krahas tyre, pjesëmarrësit në zgjedhje, kandidatët, propozuesit e kandidatëve dhe vetë votuesit kontrollojnë procesin zgjedhor. Të gjithë këta kanë të drejtë të paraqesin mjete juridike për mbrojtjen e të drejtës për votë dhe në përgjithësi ligjshmërisë së procedurës zgjedhore: në shkallë të parë vendos gjykata e faktit, vendimi i së cilës është përfundimtar, kurse sipas nenit 113.7 të Kushtetutës mund të vendos edhe Gjykata Kushtetuese. Kjo e fundit, megjithatë, nuk është e lidhur për afat për nxjerrje të vendimit, siç është gjykata e shkallës së parë e cila duhet të vendos për kundërshtimin 40 ditë para zgjedhjeve.[60] Gjatë vetë procesit të zgjedhjeve, ndërkaq, afatet për mbrojtjen e të drejtave zgjedhore janë të shkurtra. Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në **Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve** (QNR) dorëzohen me shkrim pranë **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa** (PZAP) brenda njëzetekatër (24) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.[61] Paraqitja e ankesës nuk e pengon ose ndërpret procesin e numërimit.[62] Për të gjitha ankesat e marra nga PZAP-ja vendoset jo më vonë se shtatëdhjetedy (72) orë nga momenti i pranimit të ankesave në zyrat

[55] Neni 112 (d) i **Ligjit nr.03/L-073**.
[56] Neni 112 (e) i **Ligjit nr.03/L-073**.
[57] Nenet: 7.1 (a) dhe 7.8 të **Ligjit nr.03/L-073.**
[58] Nenet: 8.2, 8.6 dhe 83.1 të **Ligjit nr.03/L-073.**
[59] Nenet: 59.2, 68.1 dhe 74.10 të **Ligjit nr.03/L-073.**
[60] Neni 10.4 i **Ligjit nr.03/L-073**.
[61] Neni 105.1 i **Ligjit nr.03/L-073**.
[62] Neni 105.2 i **Ligjit nr.03/L-073**.

qendrore të PZAP-së.[63] KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime dhe qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha ankesat që u përkasin votimit dhe numërimit të vendosura nga PZAP-ja dhe çdo apel ndaj vendimeve të PZAP-së lidhur me to të jetë vendosur nga **Gjykata Supreme e Kosovës**. Nga viti 2010, **Gjykata Kushtetuese** nuk ka autorizime në procesin zgjedhor as sa i përket kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së akteve të përgjithshme të KQZ-së dhe autoriteteve të tjera që janë në ngarkesë të administrimit të zgjedhjeve.[64] Një lloj i kontrollit të zgjedhjeve është **vëzhgimi** i tyre. Shoqatat dhe organizatat vendore (joqeveritare, qeveritare dhe ndërqeveritare) që kanë qëllim të merren më të drejtën zgjedhore dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, mund të paraqesin në KQZ kërkesën për monitorim të zgjedhjeve, me listën e vëzhguesve të tyre. Organizatat dhe shoqatat e jashtme mund të vëzhgojnë zgjedhjet në bazë të paraqitjes, në të cilën jepen emrat e vëzhguesve dhe përkthyesve të tyre eventual. Vëzhguesit ndërkombëtar marrin autorizim përkatës për vëzhgim të punës së KQZ-së, komisioneve komunale dhe këshillave të vendvotimit dhe çdo veprim që lidhet me zgjedhjet. Vëzhguesit vendorë dhe të huaj marrin akreditimet, që shërbejnë si një dokument autorizues për përcjelljen e procesit të zgjedhjeve. Kërkesa për akreditim duhet të paraqitet në KQZ në afatet kohore nga njëzetë (20) deri në tridhjetë (30) ditë para zgjedhjeve, në vartësi të statusit të kërkuesit dhe kohës për monitorim. Gjatë procesit zgjedhor, përfshirë edhe procesin e regjistrimit të votuesve, vëzhguesi i akreditуar mund të parashtrojë ankesë për çfarëdo shkelje të rregulloreve në fuqi, urdhëresave administrative, rregullave zgjedhore ose procedurave administrative pranë KQZ-së në pajtim me procedurat e saj.[65]

E drejta për informim lidhur me zgjedhjet është, në njërën anë, një e drejtë e qytetarëve për të qenë të informuar lidhur me programet zgjedhore dhe aktivitetet e listave zgjedhore dhe kandidatëve dhe, në anën tjetër, një detyrim për mjetet e informimit publik për të siguruar barazinë në informim mbi bartësit e listave zgjedhore, programet dhe kandidatët e tyre. Përveç përfaqësimit të barabartë, mjetet e informimit publik duhet të informojnë qytetarët me kohë, saktë, pa anime dhe në tërësi mbi ngjarjet e rëndësishme që kanë të bëjnë me zgjedhjet. **Fushata zgjedhore**, që nënkupton aktivitetet politike të promovuara, në mënyrë të veçantë dhe shprehimisht ndalohet në programet komerciale dhe argëtuese të emetuesve programor që kanë karakter publik, por vetëm në emisionet politiko-informative dhe emisionet speciale për procesin zgjedhor. Fushata zgjedhore nuk lejohet 24 orë para mbajtjes së zgjedhjeve dhe në ditën e votimit, deri në mbylljen e vendvotimeve kur edhe pushon **heshtja zgjedhore**.[66]

9.4. Realizimi i zgjedhjeve

9.4.1. Realizimi i zgjedhjeve për përfaqësues të popullit – veprimet zgjedhore

Procedura e zgjedhjes së deputetëve për **Kuvend të Kosovës** normohet në mënyrë të detajuar me **Ligjin nr. 03/L-073** dhe udhëzime e rregullore përkatëse për zbatimin e zgjedhjeve që miratohen nga KQZ-ja dhe organet tjera të pushtetit që janë në ngarkesë për zbatimin e zgjedhjeve. Të gjitha vendet fqinje më Kosovën afërsisht kanë infrastrukturë të ngjashme ligjore, që rregullon zgjedhjet, e cila më pas zbatohet e operacionalizohet nga komisionet qendrore zgjedhore dhe organet tjera të pushtetit shtetëror. [67]

---

63 Neni 105.3 i **Ligjit nr.03/L-073**.

64 Neni 106.1 i **Ligjit nr.03/L-073**. Deri në ndryshimet dhe plotësimet e **Ligjit nr.03/L-073** të nëntorit 2010, **Gjykata Kushtetuese** ka qenë instancë e fundit për certifikim, do të thotë që është dashur të pritet edhe rezultati i saj ndaj ankesave kundër vendimeve të **Gjykatës Supreme** lidhur me procesin zgjedhor. Cf. fusnota nr. 48, **supra**, në këtë pjesë.

65 Nenet 54-58 të **Ligjit nr.03/L-073**.

66 Nenet 47-53 të **Ligjit nr.03/L-073**.

67 Për krejt rregullativën zgjedhore në Kosovë, të nxjerrë nga **KQZ-ja**, me fillim që nga normimi i fletëvotimeve e deri te certifikimi dhe shpallja e zgjedhjeve, gjendet në këtë ueb faqe: https://kqz-ks.org/rregullat-zgjedhore/ (shikuar më 12 shtator 2022).

Procedura nis me shpalljen e zgjedhjeve. Pas konsultimit me partitë politike, Presidenti i Kosovës cakton dhe shpall datën e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës.[68] Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës mbahen në ditën e diel çdo katër (4) vjet. Zgjedhjet nuk mbahen më herët se gjashtëdhjetë (60) ditë dhe mbahen në jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit.[69] Sipas kompetencave të Presidentit, të përcaktuara me Kushtetutë, vendimi i Presidentit për të caktuar datën e zgjedhjeve bëhet jo më herët se gjashtë (6) dhe jo më vonë se katër (4) muaj para datës së zgjedhjeve. Vendimi përmban datën e zgjedhjeve.[70] Kuvendi i Kosovës zgjidhet për një mandat katër (4) vjeçar, i cili fillon që nga dita e seancës konstitutive e cila mbahet brenda tridhjetë (30) ditësh nga shpallja zyrtare e rezultateve të zgjedhjeve.[71] Pas shpërndarjes së Kuvendit të Kosovës zgjedhjet e parakohshme caktohen nga Presidenti jo më vonë se dhjetë (10) ditë pas shpërndarjes. Zgjedhjet e parakohshme nuk mund të mbahen më herët se tridhjetë (30) ditë dhe me vonë se dyzetë e pesë (45) ditë pas shpërndarjes. Zgjedhjet e parakohshme rregullohen nga ligjet dhe rregullat e njëjta të KQZ-së sikurse edhe zgjedhjet tjera, përveç se KQZ-ja mund të ndryshojë afatet kohore sipas nevojës në pajtim me rrethanat.[72] Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve bëhet publik në ”Gazetën Zyrtare të Kosovës”.[73]

Veprimi zgjedhor i radhës është paraqitja e listave zgjedhore KQZ-së nga ana partisë së regjistruar politike, koalicionit të partive apo grupi qytetarëve.[74] Fillimisht vërtetohet nëse lista zgjedhore përmbushë kushtet e kërkuara ligjore. Ato kushte kanë të bëjnë me vetë emrin e listës zgjedhore, pra quhet të cilësohet si e tillë, duhet të ketë së paku tridhjetë (30) përqind të gjinisë më pak të përfaqësuar, me përjashtim të rastit kur lista ka vetëm dy kandidatë, si dhe dokumentacionin tjetër përcjellës, siç janë: deklarata mbi pranimin e kandidaturës, pëlqimi me shkrim i bartësit të listës, vërtetimi mbi të drejtën e zgjedhjes (aktive dhe pasive) të secilit kandidat me të dhënat personal, vërtetimin mbi vendbanimin dhe vërtetimin mbi shtetësinë e kandidatëve, autorizimin e personit që paraqet listën, nënshkrimet e vërtetuara të mbështetjes për kandidatët e pavarur. Nëse nuk plotësohen këto kushte, atëherë jepet një afat për përmirësim (pesë ditë pune), në të kundërtën refuzon kandidaturën. Pas certifikimit, KQZ-ja shpall listën e përbashkët zgjedhore, e cila përmban të gjitha listat zgjedhore dhe të dhënat personale të të gjithë kandidatëve.

Në këtë fazë të procesit zgjedhor formohen organet për zbatimin e zgjedhjeve, në rend të parë **komisionet komunale të zgjedhjeve**. KQZ-ja emëron komisionet komunale të zgjedhjeve brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas shpalljes së zgjedhjeve. Emërimet përfundojnë 15 ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, përveç nëse mandati i një komisioni komunal të zgjedhjeve ndërpritet para përfundimit të afatit ose zgjatet.[75] Të gjitha komisionet komunale të zgjedhjeve administrojnë zgjedhjet përbrenda komunës, nën mbikëqyrjen ekskluzive dhe udhëzimet e KQZ-së që vepron përmes Sekretariatit të tij, duke garantuar ligjshmëri, legjitimitet dhe efikasitet të procesit zgjedhor.[76] Me administrim të zgjedhjeve brenda komunës nënkuptohen dy nivelet e zgjedhjeve, atyre të përgjithshme dhe zgjedhjeve lokale. Pas kësaj vjen deri te formimi i **këshillave të vendvotimeve**, me propozimin e komisioneve komunale të zgjedhjeve, që miratohen në fund nga **KQZ**-ja. Në kohën e përcaktuar nga **KQZ**-ja, përmes Sekretariatit, ftohen të gjitha subjektet politike të certifikuara, të përfaqësuara në kuvendin komunal, të cilat garojnë në zgjedhjet shtetërore, t’i dorëzojnë në komisionet komunale të zgjedhjeve propozimet për personat që ata dëshirojnë t’i emërojnë anëtarë të komisioneve në fjalë, të formuara në kuadër të komunës së tyre.[77] Pra, sikundër shihet, këtu vjen deri

68 Neni 4.1. i **Ligjit nr.03/L-073**.
69 Neni 4.2. i **Ligjit nr.03/L-073**.
70 Neni 4.3. i **Ligjit nr.03/L-073**.
71 Neni 4.5. i **Ligjit nr.03/L-073**.
72 Neni 4.6. i **Ligjit nr.03/L-073**.
73 Neni 4.6. i **Ligjit nr.03/L-073**.
74 Nenet 17-20 dhe 25 të **Ligjit nr.03/L-073.**
75 Neni 67.4 i **Ligjit nr.03/L-073**.
76 Neni 68.1 i **Ligjit nr.03/L-073**.
77 Neni 76.2 i **Ligjit nr.03/L-073**.

te zgjerimi i këshillave të vendvotimit dhe, për rrjedhojë, i vetë **KQZ**-së, sepse komisionet komunale të zgjedhjeve dhe këshillat e vendvotimit nuk mund të caktohen pa bekimin përfundimtar të KQZ-së, ato janë trupa të tij. Një këshill i vendvotimit është përgjegjës për sigurim të integritetit, sigurisë dhe të qetësisë në procesin e votimit dhe numërimit në vendvotim, nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë nga komisioni përkatës komunal i zgjedhjeve.[78]

Përbërja e përhershme dhe fizionomia e KQZ-së, ndërkaq, përcaktohet me Kushtetutën e Kosovës. Sipas nenit 139.1 të Kushtetutës, KQZ është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve e referendumet dhe shpall rezultatet e tyre. Komisioni përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë (neni 139.2 i Kushtetutës). Ata emërohen konform nenit 139.4 të Kushtetutës,[79] kurse pas sigurimit se individi i caktuar nga grupi parlamentar i përshtatet kërkesave të **Ligjit nr. 03/L-073**, Presidenti i Kosovës, brenda pesë (5) ditëve e konfirmon me shkrim emërimin. Emërimi hyn në fuqi në ditën e shënuar në emërimin zyrtar nga Presidenti i Kosovës.[80] Kryesuesin e KQZ-së e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të gjykatave me jurisdiksion apeli (neni 139.3 i Kushtetutës). Mandati i Kryesuesit është shtatë (7) vjet dhe përcaktohet me ligj.[81]

Asnjë vendvotim brenda qendrës së votimit nuk tejkalon 750 votues.[82] Një VV duhet të jetë mjaft i madh për të siguruar mbajtjen e drejtë të votimit duke vendosur të gjitha stacionet e punës siç janë përkufizuar në këtë ligj dhe duke siguruar fshehtësinë e votës, pamjen e lirë dhe kontrollin e kutisë së votimit, dhe qasje të papenguar për vëzhgues.[83] Lista e përhershme e votimeve përditësohet dhe përcaktohet përfundimisht para zgjedhjeve. Paralel me këtë, KQZ përgatitë materialin zgjedhor: përcakton numrin e fletëvotimeve dhe rezervën e tyre në një përqindje të caktuar (5 % e numrit të votuesve në listën e votuesve), përcakton tekstin, formën dhe dukjen e fletëvotimit, shtypshkronjën, përcjell shtypjen e tyre sipas modelit të propozuar. Këtë material zgjedhor e siguron **KQZ**-ja, si atë që është i shtypur (listat e votuesve, listën e përbashkët zgjedhore, ekstraktin nga listat zgjedhore, librin e votimit, vendimet dhe formularët për këshillat e votimit), ashtu edhe materialin tjetër zgjedhor (kutitë e votimit, paravanët apo mbrojtësit e fshehtësisë gjatë votimit), thasët për largimin e materialit zgjedhor, sprejin identifikues, llampat fluoreshente etj).

Kryesuesi i këshillit të vendvotimit (KVV), së bashku me një anëtar marrin materialin sensitiv në **Komisionin Komunal të Zgjedhjeve** (KKZ) para orës 06:00 dhe e plotësojnë **Formularin e Pranim-Dorëzimit**. Së bashku me policinë, secili kryesues i KVV-së me një anëtar shkojnë në vendvotimin e tyre përkatës. Kryesuesi dhe anëtarët tjerë kontrollojnë të gjithë materialin dhe e hapin **librin e votimin**, ku konstatohet se, materiali është në rregull dhe, nëse ka ndonjë mungesë eventuale apo ndonjë formular gabim, menjëherë njoftohet KKZ-ja. Kryesuesi e konstaton pjesëmarrjen e anëtareve dhe vëzhguesve në vendvotim dhe i shënon të gjitha të dhënat e tyre, duke shënuar në librin e votimit edhe subjektin apo organizatën që përfaqësojnë dhe, në fund, konstaton nëse ka qenë çdo në rregull. Kryesuesi dhe anëtarët i marrin **Formularin e Përputhjes së Rezultateve** (FPR) dhe **Formularin e Rezultatit të Kandidatëve** (FRK) dhe shënojnë të dhënat si në vijim: qendrën e votimit, numrin e vendvotimit, numrat e shiritave të sigurisë së kutisë së votimit (shiritat mbyllës), numrin e votuesve të përcaktuar në atë vendvotim, numrin e fletëvotimeve të pranuara nga KKZ-ja

78 Neni 74.10 i **Ligjit nr.03/L-073**.

79 Neni 139.4 i **Kushtetutës së Kosovës**:
"Gjashtë (6) anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara. Nëse në Kuvend janë të përfaqësuara më pak grupe, grupi a grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë. Një (1) anëtarë emërohet nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin Serb të Kosovës dhe tre (3) anëtarë nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë".

80 Neni 61.3 (a) i **Ligjit nr.03/L-073**.

81 Neni 61.2 i **Ligjit nr.03/L-073**.

82 Neni 82.1 i **Ligjit nr.03/L-073**.

83 Neni 82.2 i **Ligjit nr.03/L-073**.

për vendvotimin. Pasi kryesuesi me anëtarët konstatojnë se çdo gjë është në rregull, atëherë kryesuesi bën ndarjen e pozitave sipas formulës që e përcakton KQZ-ja, dhe atë si vijon: kryesuesi, zyrtari i identifikimit, dhënësi i fletëvotimit, mbikëqyrësi i kutisë së votimit dhe kontrolluesi i rreshtit. Pasi konstaton se çdo gjë është në rregull, kryesuesi bënë hapjen e vendvotimit dhe shënon në librin e votimit se, vendvotimi është hapur me kohë dhe raportin në KKZ për hapjen e vendvotimit. Kryesuesi mban shënime në librin e votimit për çdo ngjarje të ndodhur në ditën e votimit dhe raporton në KKZ-në sipas orarit të përcaktuar nga KQZ-ja. Në ora 19:00, kur vjen koha e mbylljes, kryesuesi del në korridor dhe shikon nëse ka ndonjë votues në radhë. Nëse nuk ka, atëherë mbyllet vendvotimi. Më pas, kryesuesi dhe anëtarët mblidhen në një tavolinë pune ku kanë shikueshmëri edhe vëzhguesit dhe i hapin FPR-të dhe FRK-të e njëjta që i kanë shënuar në mëngjes dhe më pas i presin shiritat mbyllës të kutisë së votimit, mbajnë shënimet e tyre, i nxjerrin fletëvotimet, konstatojnë numrin e tyre brenda dhe në secilën rubrikë në FPR dhe FRK shënojnë saktë të dhënat si vijon: fletëvotimet në kuti, fletëvotimet e vlefshme, fletëvotimet e pavlefshme, fletëvotimet e dëmtuara, fletëvotimet e papërdorura dhe i numërojnë secilën për subjekt fillimisht e më pas për kandidatët. Pas kësaj pason shënimi i të dhënave në FPR dhe FRK, vendosja e tyre në zarfet përkatës të të gjithave, Përveç atyre që nuk janë përdorur dhe të vlefshmet. Mandej mbyllin kutinë e votimit dhe prapë i shënojnë numrat e shiritave të tjerë të sigurisë në FPR dhe libër të votimit, ndërsa një kopje të FPR-së e vendosin jashtë derës në vendvotim dhe e raportojnë në KKZ, duke vijuar në fund me dërgimin e kutisë së votimit në KKZ.

Rregulla të posaçme vlejnë për votim në botën e jashtme: Votuesi me të drejtë vote i cili përkohësisht mungon në Kosovë mund të votojë për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës nëse ai ose ajo ka aplikuar suksesshëm për votim jashtë Kosovës dhe ka votuar në përputhje me dispozitat e **Ligjit nr. 03/L-073.** Votuesi me të drejtë vote mund të aplikojë për të marrë një fletëvotim për votim jashtë Kosovës, duke dorëzuar të plotësuar aplikimin apo formularin për votim jashtë Kosovës (aplikimi përmes-postës) në formën në dispozicion nga faqja elektronike e KQZ-së. Vota përmes votimit jashtë Kosovës duhet të pranohet nga KQZ-ja para ditës së zgjedhjeve, sikurse përcaktohet me anë të rregullave të KQZ- së.[84]

Votuesi voton në vendvotimin ku është i regjistruar në regjistrin e votuesve, kurse përjashtimisht mund të votohet në një vend tjetër. Votohet personalisht, vetëm një herë, në mënyrë të fshehtë dhe në lista votuese të vërtetuara, në kohën nga hapja e vendvotimit në 7:00h deri në mbylljen e tij në 19h.[85] Votimi vazhdon deri të mos votojnë të gjithë votuesit e ndodhur në vendvotim në kohën e mbylljes së tij zyrtare. Votimi nis me verifikimin e kutisë së votimit dhe kontrollimin e saj. Në librin e votimit shënohet se kutia e votimit është e zbrazët, e nënshkruajnë anëtarët e këshillit të vendvotimit. Kutia vuloset dhe rrethohet me shirit.

Para votimit, votuesi tregon identitetin e vet me leje të njoftimit ose dokument tjetër dhe, pas identifikimit dhe shënimit në listën e votuesve, nënshkruhet në ekstraktin nga lista e votimit, merr fletëvotimin dhe pa u vonuar i drejtohet vendit për votim ku është siguruar fshehtësia e votës. Duke ushtruar të drejtën e tij/saj të votës, votuesi voton për një (1) subjekt politik të certifikuar dhe mund të votoj për një (1) kandidat nga lista e kandidatëve të këtij subjekti politik. Nëse në fletëvotim janë shënuar më shumë se një (1) kandidat, vetëm vota për subjektin politik llogaritet.[86] Pas kësaj, votuesi lëshon vendin e votimit. Para kësaj, me rastin e marrjes së fletëvotimit, gishti tregues i dorës së djathtë spërkatet me sprejin special, që paraqet dëshmi se votuesi ka votuar. Paraprakisht vërtetohet me **llambë ultra-violete** nëse ekzistojnë shenjat e sprejit në fjalë.

Votuesi i cili është me aftësi të kufizuar në atë mënyrë që nuk është në gjendje të shënojë ose hedh fletëvotimin dhe/ose është analfabet mund të ndihmohet nga një person tjetër i zgjedhur nga votuesi nëse ai kërkon një ndihmë të tillë. Personi i tillë e ndihmon vetëm një votues dhe nuk është anëtar i

[84] Nenet 85-87 dhe 97-97 të **Ligjit nr.03/L-073.**
[85] Neni 88.1 i **Ligjit nr.03/L-073**.
[86] Neni 110.4 i **Ligjit nr.03/L-073**.

KVV-së ose vëzhgues i akreditуar.[87] Personat e paaftë (paaftësia fizike, mjekësore ose çfarëdo paaftësie tjetër) apo që nuk kanë mundësi për të votuar mund të votojnë nga shtëpia apo institucioni tjetër ku gjenden (burgu, kazerma, spitali etj), në praninë e anëtarëve të këshillit të votimit. KQZ-ja përcakton rregullat për votim të personave me nevoja të veçanta.[88]
Pas mbylljes së vendvotimit nis vërtetimi i rezultateve të votimit. Fillimisht konstatohet numri i fletëvotimeve të papërdorura (votuesit që nuk kanë dalë në zgjedhje), pastaj në bazë të ekstraktit të fletëvotimeve përcaktohet numri i votuesve që kanë votuar. Hapet kutia e votimit dhe, pasi të vërtetohet fletëvotimi kontrollues, ndahen fletëvotimet e vlefshme dhe fletëvotimet e pavlefshme (të pavlefshme janë ato fletëvotime që nuk mund të konstatohet me siguri se për kënd është votuar: më shumë numra të rrumbullakuar, asnjë i rrumbullakuar, fletëvotim i prishur me qëllim etj.), numërohen fletëvotimet e vlefshme dhe fletëvotimet e pavlefshme, përcaktohet numri i votave për çdo listë zgjedhore dhe çdo gjë shënohet në formularët dhe dokumentet e miratuara nga **KQZ-ja** për futjen në procesverbal me qëllim evidentimi të punës së këshillit të vendvotimit (formularët për përputhjen e rezultatit dhe librat e zgjedhjeve). Nëse numri i fletëvotimeve të përdorura është më i madh se numri i votuesve që kanë votuar, duhet të përsëritet votimi. Dokumentacionin për punën e këshillit të votimit, që ka cilësinë e procesverbalit mbi punën e tij, libra e votimit, e nënshkruajnë krejt anëtarët e këshillit të votimit dhe evidentohen vërejtjet dhe mendimet e tyre.

Materialin zgjedhor (fletëvotimet, procesverbalet, përkatësisht formularët dhe librat që janë të vulosura në zarfe), këshilli i votimit ia dorëzon trupit punues të **KQZ-së** në komunë, pa vonesë, sapo të ketë vërtetuar rezultatet e votimit dhe më pastaj krejt materialin zgjedhor e dërgon te pika e caktuar nga KQZ-ja. Pas marrjes së materialit zgjedhor, përfshirë votimet nga jashtë dhe çdo votim tjetër, KQZ-ja veçanërisht vërteton numrin e tërësishëm të votuesve, votuesve që kanë votuar, numrin e tërësishëm të fletëvotimeve, numrin e fletëvotimeve të papërdorura, të pavlefshme, të vlefshme dhe, së fundi, numrin e votave të vlefshme që ka fituar secila listë zgjedhore. KQZ-ja, në bazë të procesverbaleve (nuk rinumëron fletëvotimet), konform nenit 106.1 të **Ligjit nr. 03/L-073** certifikon rezultatin e zgjedhjeve dhe i publikon në **Gazetën Zyrtare të Kosovës**, në ndërkohë informon publikun me rezultatet preliminare të zgjedhjeve. Pas kësaj pason ndarja e vërtetimeve deputetëve të zgjedhur. Në rastet kur KQZ-ja ka vendosur për anulimin e rezultatit zgjedhor ose për përsëritjen e zgjedhjeve në të gjitha apo vetëm në disa vendvotime, rezultati përfundimtar i zgjedhjeve vërtetohet pas përfundimit të votimit të përsëritur.

Pas përfundimit të krejt procedurës zgjedhore, materiali zgjedhor në bazë të të cilit është përcaktuar rezultati zgjedhor, ruhet sipas dispozitave mbi ruajtjen e kategorive të materialit regjistrues (që përmban të dhëna): një pjesë ruhet përgjithmonë (procesverbalet), kurse një tjetër pjesë ruhet përkohësisht (fletëvotimet).

9.4.2. Realizimi i zgjedhjeve për Presidentin e Republikës

Sikundër u tha më sipër, **Presidenti i Republikës** zgjidhet nga **Kuvendi i Kosovës**, në mënyrë të tërthortë, jo të drejtpërdrejtë. Për pasojë, lidhur me këtë do të flasim në pjesën që ka të bëjë me këtë organ të rëndësishëm shtetëror në Kosovë.

9.4.3. Realizimi i zgjedhjeve lokale – veprimet zgjedhore

Bazë kryesore juridike për organizimin dhe zbatimin e zgjedhjeve lokale në Kosovë është **Ligji nr. 03/L-072**, por edhe **Ligji nr. 03/L-073** dhe **Ligji nr. 03/L-040 si** dhe aktet tjera nënligjore, kryesisht udhëzimet e nxjerra nga komisionet komunale të zgjedhjeve, por edhe vendimet e udhëzimet që nxirren nga organi suprem që ka autorizime të caktuara për organizimin dhe mbikëqyrjen e secilit lloj të zgjedhjeve në çdo

87 Neni 89.5 i **Ligjit nr.03/L-073**.
88 Neni 99 i **Ligjit nr.03/L-073**.

cep të Kosovës – **KQZ**-ja dhe Sekretariati i tij**.** U mor vesh, Kushtetuta e Kosovës përbën fundamentin juridik edhe për këtë lloj të zgjedhjeve në Kosovë. Vlen të theksohet se dispozitat e **Ligjit nr. 03/L-072** në pjesën dërmuese i referohen **Ligjit nr.03/L-073**, të cilat, **mutatis mutandis**, zbatohen edhe për zgjedhjet lokale. Dispozitat e **Ligji nr.03/L-073** që zbatohen edhe në organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve lokale kanë të bëjnë me sa vijon:

- dispozitat mbi konfirmimin dhe certifikimin e rezultateve zgjedhore (neni 6);
- dispozitat mbi sistemin zgjedhor (neni 7);
- dispozitat mbi të drejtën zgjedhore pasive (neni 9.2);
- dispozitat mbi të drejtën për të votuar, regjistrimin dhe certifikimin (nenet 12-14);
- dispozitat lidhur me kodin e mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët (neni 15);
- dispozitat mbi financimin e zgjedhjeve lokale (neni 16);
- dispozitat mbi fushatën zgjedhore dhe njoftimin për ngjarjet politike (neni 17);
- dispozitat mbi vëzhguesit e zgjedhjeve (neni 19);
- dispozitat mbi rolin dhe pozitën e KQZ-së (neni 20);
- dispozitat mbi rolin dhe pozitën e komisioneve komunale të zgjedhjeve (neni 21);
- dispozitat mbi këshillat e vendvotimeve (neni 22);
- dispozitat mbi qendrat e votimit dhe votimin (neni 23);
- dispozitat mbi votimin jashtë Kosovës (neni 24);
- dispozitat mbi votimin e personave me nevoja të veçanta (neni 25);
- dispozitat mbi procesin e numërimit dhe shpalljen e rezultateve zgjedhore (neni 26);
- dispozitat mbi informimin e votuesve dhe mediat (neni 27); dhe, së fundi)
- dispozitat mbi Panelin zgjedhor për ankesa dhe parashtresa (neni 27).

Edhe **Ligji nr. 03/L-040** zbatohet në masë të konsiderueshme në zgjedhjet lokale, në veçanti sa i përket dispozitave që kanë të bëjnë me sa vijon:

- mandatin e kuvendeve të komunave dhe kryetarëve të komunave (neni 5);
- zëvendësimin e anëtarëve të kuvendit të komunës (neni 10); dhe
- përfundimin e mandatit dhe shkarkimin e kryetarit të komunës (neni 11).

Presidenti cakton dhe shpall datën e zgjedhjeve lokale, pas konsultimit me partitë politike.[89] Me rastin e caktimit dhe shpalljes së ditës së zgjedhjeve duhet të merren parasysh dy kufizime: zgjedhjet për organet vetëqeverisëse lokale mbahen ditën e diel për çdo katër (4) vjet; ato nuk mund të mbahen më herët se gjashtëdhjetë (60) ditë para përfundimit të mandatit dhe jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas përfundimit të mandatit.[90] Presidenti cakton dhe shpallë zgjedhjet lokale në të gjitha komunat e Kosovës, apo vetëm në ato ku ka përfunduar mandati i këshilltarëve ekzistues. Vendimi për caktimin e zgjedhjeve bëhet publik në Gazetën Zyrtare të Kosovës.[91] Nga momenti i nxjerrjes së vendimit mbi caktimin dhe shpalljen e datës së zgjedhjeve, fillon rrjedhja e afateve për ndërmarrjen e veprimeve zgjedhore. Në rastet kur zgjedhjet parlamentare mbahen së bashku me zgjedhjet lokale për këshilltarë komunalë, atëherë një pjesë e veprimeve zgjedhore që ndërmerren për zgjedhjet qendrore vlejnë dhe kanë efekt edhe për zgjedhjet lokale, siç janë: formimi i këshillave të votimit, caktimi i vendvotimeve, përditësimi i regjistrit të votuesve, pranimi dhe dorëzimi i materialit zgjedhor.

Veprimin zgjedhor të propozimit të kandidatëve për listat zgjedhore mund ta ndërmarrin partitë e regjistruara politike, koalicionet e partive politike, nismat qytetare dhe kandidatë e pavarur. Secili subjekt politik i certifikuar do të paraqitet në "listë të hapur" votimi për secilën komunë në të cilën subjekti politik i certifi-

[89] Neni 4.1 i **Ligjit nr. 03/L-040**.
[90] **Ligji nr. 03/L-040,** neni 4.2.
[91] Ibid., neni 4.5.

kuar garon në zgjedhje.[92] Çdo listë e kandidatëve përmban së paku 30% të kandidatëve të certifikuar nga gjinia tjetër.[93] Kreu III (regjistrimi i partive politike dhe certifikimi i subjekteve politike) si dhe çfarëdo dispozite e **Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës** lidhur me këtë çështje, vlejnë në mënyrë të përshtatshme edhe për zgjedhjet lokale.[94] Kreu IV (certifikimi i kandidatëve), dhe çfarëdo dispozite e ndërlidhur me këtë çështje, e **Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës**, në mënyrë të përshtatshme vlejnë edhe për zgjedhjet lokale.[95]

Formimi i organeve për zbatimin e zgjedhjeve përfshinë dhe nënkupton zgjerimin e komisionit komunal zgjedhor dhe, për rrjedhojë, edhe të KQZ-së. **KKZ-ja** në përgjithësi ka shtatë (7) anëtarë, ky numër mund të rritet nëse numri i subjekteve politike që kualifikohen për të qenë pjesë e komisionit është më i madh.[96] **KKZ**-ja emërohet nga **KQZ**-ja brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas shpalljes së zgjedhjeve lokale.[97] Çdo gjë tjetër rreth veprimtarisë zgjedhore të **KKZ**-së normohet me dispozitat e kreut XI të **Ligjit nr.03/L-073**. E njëjta vlen edhe për këshillat e vendvotimeve, të cilët normohen me kreun XII të Ligjit: këshillat në fjalë, nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë nga **KKZ**-ja, zbatojnë votimin dhe vërtetojnë rezultatet e zgjedhjeve në vendvotime. Kur përnjëherë organizohen zgjedhjet parlamentare dhe zgjedhjet lokale, këshillat e vendvotimeve të formuara për zgjedhjet parlamentare ndërmarrin veprime zgjedhore në zgjedhjet lokale.

Veprimin zgjedhor të caktimit të vendvotimit e ndërmerr **KKZ-ja**, me propozimin e administratës lokale, para çdo zgjedhje, sipas kritereve të njëjta që vlejnë për zgjedhjet parlamentare dhe shpall adresat e vendvotimeve në mënyrë që votuesit me kohë të jenë në dijeni për vendin e tyre të votimit.

Në zgjedhjet lokale, gjithashtu vjen deri te përditësimi i regjistrit të votuesve, përkatësisht përditësimi i regjistrit të votuesve në komunën ku mbahen zgjedhjet. **KQZ-ja** krijon dhe mban listën e personave që kanë të drejtë të votojnë në zgjedhje të veçanta.[98] KKZ-ja ndërmerr veprime zgjedhore që kanë të bëjnë me përgatitjen e materialit për zgjedhjeve lokale, duke shërbyer si propozues i tyre, që më pastaj **mirato-hen** nga **KQZ**-ja, në veçanti materialet zgjedhore si vijon: propozimin e përmbajtjes, formës dhe dukjes së fletëvotimit, propozimi për caktimin e numrit të tërësishëm të fletëvotimeve, me rezervën e njëjtë në përqindje si për zgjedhjet e përgjithshme, propozimi për caktimin e shtypshkronjës dhe përcjellja e shtypjes së fletëvotimeve dhe materialit tjetër zgjedhor për zgjedhjet lokale, propozimi për listën e përbashkët zgjedhore, propozimin për ekstraktin e regjistrit të votuesve në komunë, vërtetimin e të drejtës së zgjedhjes, zarfeve zyrtarë, formularëve, vendimeve dhe organizimeve të tjera për pranim dhe dorëzim të materialit zgjedhor. Lidhur me materialin permanent zgjedhor, siç janë kutitë e votimit, paravanët (mbrojtësit e fshehtësisë gjatë votimit) dhe mjetet për zbatimin e zgjedhjeve (llambat fluoreshente, spreji për identifikim), përkujdeset administrata lokale. Krejt materiali zgjedhor iu dërgohet këshillave të vendvotimit, ose ata e marrin këtë në selinë e KKZ-së, para ditës së zgjedhjeve (dita e saktë përcaktohet me udhëzimin për zbatimin e zgjedhjeve konkrete).

Votuesi voton në vendvotimin në të cilin është i regjistruar në regjistrin e votuesve e përjashtimisht mund të votoj edhe jashtë tij. Votohet personalisht: Duke ushtruar të drejtën e tij/saj të votës, votuesi voton një (1) subjekt politik të certifikuar dhe mund të votoj për një (1) kandidat nga lista e kandidatëve të këtij subjekti politik. Nëse në fletëvotim janë shënuar më shumë se një (1) kandidat, vetëm vota për subjektin politik llogaritet.[99] Vota e hedhur për subjektin politik konsiderohet si votë për kandidatin e parë në listën e kandidatëve të subjektit politik. KQZ-ja siguron që fletëvotimi nuk e lejon votuesin të

92 **Ligji nr. 03/L-040,** neni 7.3.
93 Ibid., neni 7.2.
94 Ibid., neni 13.
95 **Ligji nr. 03/L-040,** neni 14.
96 **Ligji nr.03/L-073,** neni 67.1**.**
97 Ibid., neni 67.4**.**
98 Neni 64.2 (c) i **Ligjit nr.03/L-073**.
99 **Ligji nr. 03/L-040,** neni 7.4.

votojë njëkohësisht për subjektin politik dhe për kandidatin e parë në lisën e kandidatëve të këtij subjekti politik.[100] Sa i përket kohës së votimit, nisjes dhe përfundimit të votimit, vërtetimit të identitetit të votuesit, sigurimit të fshehtësisë së votimit, votimit me ndihmën e personit tjetër, veprimet zgjedhore janë të njëjta si në procedurën e zgjedhjeve për deputetë të Kuvendit të Kosovës.
Veprimet zgjedhore pas mbylljes së vendvotimit nisin dhe zbatohen sipas renditjes së njëjtë si për zgjedhjet parlamentare. Konstatohet numri i fletëvotimeve të papërdorura, numri i votuesve që ka votuar, hapet kutia e votimit, vërtetohet fletëvotimi kontrollues, ndahen fletëvotimet e vlefshme dhe fletëvotimet e pavlefshme dhe numërohen dhe, në fund, vërtetohet numri i votave për secilin vendvotim. Të gjitha këto shënohen në procesverbal. Edhe këtu zgjedhjet përsëriten nëse numri i fletëvotimeve të përdorura është më i madh se numri i votuesve që kanë votuar ose nëse nuk gjendet fletëvotimi kontrollues. Procesverbalin mbi punën e nënshkruajnë anëtarët e këshillit të vendvotimit dhe shënohen vërejtjet e tyre eventuale, mendimet dhe faktet tjera me rëndësi për votimin e përfunduar.

Këshilli i vendvotimit, menjëherë pasi të konstatoj rezultatin e votimit, materialin zgjedhor (procesverbalet, ekstraktet nga regjistri i zgjedhësve, fletëvotimet e klasifikuara në zarfe të mbyllura dhe dokumentacioni tjetër) ia dërgon KKZ-ja menjëherë. Më pas, **KKZ**-ja menjëherë as mbylljes së vendvotimit, në mënyrë të veçantë konstaton numrin e tërësishëm të votuesve, votuesve që kanë votuar, numrin e tërësishëm të fletëvotimeve, numrin e papërdorur të fletëvotimeve, të pavlefshme, të vlefshme dhe numrin e votave që ka fituar secila listë zgjedhore dhe, në bazë të procesverbaleve të dorëzuara, konstaton rezultatet e zgjedhjeve. Certifikimin dhe shpalljen e tyre e bënë KQZ-ja,[101] organit që themelon komisionet komunale të zgjedhjeve dhe këshillat e vendvotimeve.[102] KQZ-ja, menjëherë ditëve në vijim, ndan certifikatat për mandatet e fituara nga këshilltarët. Nëse KQZ-ja apo organi kompetent anulon zgjedhjet për shkak të parregullsive në zbatimin e tyre, rezultatet përfundimtare vërtetohen pas votimit të përsëritur. Në procedurat eventuale të nisur sipas kundërshtimit, përkatësisht ankesës organeve kompetente të përcaktuara me **Ligjin nr.03/L-073**, afatet janë të njëjta si në zgjedhjet parlamentare. Nëse miratohet kërkesa sipas mjetit juridik, atëherë vjen deri te evitimi i shkeljeve zgjedhore sipas afateve dhe procedurës së përcaktuar ligjore dhe vendimit meritor që ka aprovuar kërkesën. Procedura sipas ankesës kushtetuese nga neni 113.7 i **Kushtetutës së Kosovës** asnjëherë nuk mund të çoj në anulim të zgjedhjeve, përsëritje të tyre të tërësishme ose të pjesshme, por vetëm në konstatimin e shkeljes kushtetuese dhe restaurimin e të drejtës apo lirisë së shkelur.

10. Zgjedhjet në Shqipëri

10.1. Pasqyrë e zgjedhjeve të deritanishme parlamentare

Për prodhimin e këtij seksioni lidhur me të drejtën zgjedhore dhe zgjedhjet në Shqipëri ne kemi përdorur një literaturë klasike të së drejtës kushtetuese shqiptare, por edhe materiale të tjera dhe hulumtime të sektorit privat që kanë përcjellë dhe hulumtuar zgjedhjet shqiptare.[103]

---

100 **Ligji nr. 03/L-040**, neni 7.5.
101 **Ligji nr.03/L-073,** neni 64.2 (“h” dhe ”i“).
102 Ibid., Neni 64.2 (“j”).
103 Cf. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, *Manual i Komisionit të Zonës së Administrimit të Zgjedhjeve* (Tiranë: 2015). Në internet: www.cec.org.al (shikuar mmë 3 tetor 2022); Luan Omari dhe Aurela Anastasi, *E drejta kushtetuese* (“Dajti 2000”: 2017); *BROSHURË INFORMATIVE MBI PROCESET ZGJEDHORE PARLAMENTARE DHE LOKALE NË SHQIPËRI, MBI PARTITË POLITIKE, LEGJISLACIONIN, REKOMANDIMET E OSBE/ODIHR* (1991-2020). *Me ilustrime krahasuese nga Holanda, Kroacia, Sllovenia dhe Estonia* (Tiranë: 2020). Në internet: www.isp.com.al (shikuar më 3 tetor 2022); *KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË* (miratuar me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 dhe ndryshuar me ligjet nr.74/2012, datë 19.07.2012, nr. 31/2015, datë 02.04.2015, nr. 101/2020, datë 23.7.2020, dhe nr. 118/2020, datë 5.10.2020) OSCE, *MISIONI NDËRKOMBËTAR I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE. Republika e Shqipërisë – Zgjedhjet Parlamentare, 25 prill 2021. Deklaratë e Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake* (Tiranë 2021). Në internet: chrome-extension://efaidnbmnnnibpca jpcglclefindmkaj/ https: //www.osce.org/files/f/documents/0/6/484802.pdf (shikuar më 3 tetor 2022).

Pas çdo palë zgjedhjesh, njëjtë si në Kosovë, në Shqipëri diskutohet sistemi zgjedhor. Që nga viti 1991 pas përmbysjes së regjimit komunist në Shqipëri e deri tani janë mbajtur 10 zgjedhje të përgjithshme parlamentare, 2 prej tyre zgjedhje të parakohshme, ndërkohë deputetët janë zgjedhur duke u aplikuar disa sisteme zgjedhore të ndryshme në periudhën 1991-2021.
Në Shqipëri janë zbatuar sistemet mazhoritare, sistemi (mazhoritar me korrektim proporcional kombëtar), proporcional rajonal me lista të mbyllura dhe i fundit proporcional rajonal me lista të hapura. Rasti i vetëm që Shqipëria ka aplikuar sistemin mazhoritar janë zgjedhjet e 31 marsit 1991.

Sistemi i përzier është aplikuar disa herë në Shqipëri, duke filluar nga viti 1992, ku 100 deputetë zgjidheshin drejtpërdrejtë sipas sistemit mazhoritar, ndërsa 40 të tjerë plotësoheshin me anë të sistemit proporcional. Prej vitit 2009, Shqipëria aplikon sistemin proporcional rajonal të mbyllur. Në zgjedhjet e fundit të 25 prillit 2021 u përdor sistemi zgjedhor proporcional rajonal me lista te hapura. Ky sistem nënkupton që zgjedhësit përveç siglës së partisë politike duhet të votojnë dhe për kandidatin/en e parapëlqyer prej tyre.

Në pjesën e mëposhtme është paraqitur në mënyrë të përmbledhur sistemi elektoral i zbatuar në disa prej zgjedhjeve të përgjithshme të mbajtura.

10.1.1. Sistemi elektoral për zgjedhjet në Kuvendin Popullor në vitin 1991 dhe rezultatet

Zgjedhjet e para pluraliste në Shqipëri u mbajtën më 31 mars të vitit 1991. Sistemi elektoral i aplikuar në këto zgjedhje është ai mazhoritar me dy raunde. Pra nëse asnjë nga kandidatët në zonat një emërore nuk arrin të fitojë më shumë se 50% + 1 votë atëherë dy kandidatët me rezultatin më të mirë (me më shumë se 30% të votave) të arritur në raundin e parë, kalojnë në raundin e dytë, i cili është mbajtur një javë pas ditës së zgjedhjeve, pra më 7 prill të vitit 1991. Fitues në raundin e dytë quhet kandidati që ka fituar numrin më të madh të votave.

Në logjikën e sistemit mazhoritar vendi është ndarë në 250 zona elektorale një emërore. Në raundin e parë të zgjedhjeve janë fituar 242 mandate nga të cilat 162 prej tyre nga Partia e Punës së Shqipërisë (PPSH), 66 mandate Partia Demokratike (PD), 3 mandate organizata Omonia dhe 1 mandat Komiteti i Veteranëve.

10.1.2. Sistemi elektoral për zgjedhjet në Kuvendin Popullor në vitin 1996

Sistemi elektoral i aplikuar në zgjedhjet parlamentare të vitit 1996 është sërish një sistem miks por ndryshe nga viti 1992, jo më një sistem miks i varur, por i pavarur ku performanca në pjesën mazhoritare të subjekteve politike nuk korrigjohet nga performanca në rezultate e të njëjtave subjekteve në pjesën proporcionale. Pra, të dy pjesët e sistemit funksionojnë në mënyrë të pavarur.
Sipas Ligjit Nr.8055, datë 01.02.1996 “Për ndryshimet në ligjin Nr.7556, datë 04.02.1992, Për Zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë” thuhet: Neni 3 “Kuvendi Popullor përbëhet nga 140 deputetë, nga të cilët 115 zgjidhen drejtpërdrejt në zona një emërore, kurse 25 mandatet e tjerë shtesë u jepen kandidatëve që janë në listat e subjekteve politikë në shkallë vendi, në bazë të votave të fituara në raundin e parë, sipas rregullit të përcaktuar në nenin 11”.

10.1.3. Sistemi zgjedhor i zbatuar në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2009

Sistemi zgjedhor i zbatuar në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë më 28 qershor 2009 është ai proporcional rajonal me lista të mbyllura. Ndryshimi i sistemit zgjedhor është reflektuar dhe në Kushtetutë ku shprehimisht thuhet se: Neni 64: “Kuvendi i Shqipërisë përbëhet nga 140 deputetë, të zgjedhur me sistem proporcional me zona zgjedhore shumë emërore. Zona zgjedhore shumë emërore përputhet me ndarjen administrative të një prej niveleve të organizimit administrativo-territorial”.

10.1.4. Sistemi zgjedhor i zbatuar në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2013

Baza kushtetuese e sistemit zgjedhor nuk ka ndryshuar nga zgjedhjet e vitit 2009. E njëjta vlen edhe për kuadrin ligjor, i cili ka qenë i përcaktuar me Ligjin nr. 10/019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" (me ndryshimet e plotësimet me Ligjin nr. 74/2012 (19 korrik 2012). Mënyra zgjedhjes ka ngelë e njëjtë: të gjithë 140 deputetët janë zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kanë ekzistuar 12 zona zgjedhore me më shumë deputetë, që i përgjigjet regjioneve administrative të Shqipërisë (nga 4 deri 32 ulëse). Sistemi zgjedhor ka qenë proporcional: të gjithë 140 anëtarët e Kuvendit të Shqipërisë janë zgjedhur përmes sistemit proporcional me zona zgjedhore që, siç u tha, iu përshtaten 12 regjioneve administrative të Shqipërisë. Vendet ndahen për koalicionet zgjedhore me përdorimin e **metodës D'Hondt** (1, 2, 3, 4, 5 etj.), kurse për partitë politike përdoret **metoda Sainte-Lague** (1, 3, 5, 7 etj). Pragu për fitimin e vendit në Kuvend ka qenë 3% për partitë politike kurse 5% për koalicionet parazgjedhore. Vendet vakant mes dy zgjedhjeve plotësoheshin me kandidatët në listën zgjedhore që kanë qenë nga partia e njëjtë dhe të gjinisë së njëjtë nga pararendësi. Procesi i plotësimit të vendeve vakante nuk ka marrë parasysh rangimin e kandidatit në listën zgjedhore. Ky proces ka mundur të vazhdojë deri më të mos ketë kandidatë të gjinisë së njëjtë në listë.

Kërkesat për votim kanë qenë të njëjta, si në zgjedhjet tjera: mosha 18-vjeçare, shtetësia shqiptare dhe mospasja e një vendimi gjyqësor që të merr të drejtën në fjalë. Për kandidatët për deputetë, ndërkaq, është kërkuar banimi në Shqipëri për gjashtë muajt e fundit. Nominimi duhet të ketë ardhur nga një parti politike e njohur, koalicion, organizatë ose shoqatë. Së paku 30 % e listës shumëemërore dhe njëri nga tre emrat e parë duhet të jenë të secilës gjini. Përkrahja e 300 ose më shumë zgjedhësve në rast të kandidatëve të pavarur është kërkuar.

10.1.5. Sistemi zgjedhor i zbatuar në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2017 në Shqipëri u mbajtën në Shqipëri më 25 qershor. Ato fillimisht u caktuan për në 18 qershor, por pas një bojkoti të mundshëm të njoftuar nga partitë opozitare, gjatë një krize të madhe politike që zgjati 3 muaj, u arrit një marrëveshje mes të gjitha partive politike më 18 maj për të ndryshuar datën. Më 26 qershor, rezultatet e pjesshme sugjeruan se socialistët kishin fituar shumicën. Zgjedhjet e mëparshme parlamentare u mbajtën më 23 qershor 2013, që rezultoi me një fitore për Aleancën e drejtuar nga Partia Socialiste për Shqipërinë Evropiane, e cila mori 57.6% të votave, duke fituar 83 nga 140 vende. Aleanca për Punësim, Prosperitet dhe Integrim e opozitës, kryesuar nga **Sali Berisha** i Partisë Demokratike mori pothuajse 39.5% të votave dhe fitoi 57 vendet e tjera. Partia Socialiste e udhëhequr nga **Edi Rama** formoi qeverinë.

Sistemi zgjedhor nuk ka dalluar substancialisht nga ai i vitit 2013: 140 anëtarë të Parlamentit u zgjodhën në dymbëdhjetë njësi zgjedhore shumëanëtarëshe bazuar në dymbëdhjetë qarqe duke përdorur përfaqësimin proporcional të listës së mbyllur me një prag zgjedhor prej 3% për partitë dhe 5% për aleancat. Vendet u ndanë për koalicionet zgjedhore me përdorimin e **metodës D'Hondt** (1, 2, 3, 4, 5 etj.), kurse për partitë politike përdoret **metoda Sainte-Lague** (1, 3, 5, 7 etj).

Ndryshimet demografike çuan në disa ndryshime në numrin e vendeve për disa zona elektorale; Tirana fitoi dy vende dhe Durrës një, ndërsa Korça, Berati dhe Kukësi humbën nga një vend. Pragu zgjedhor ngeli i njëjtë dhe kushtet për realizimin e të drejtave zgjedhore nuk ndryshuan.

10.1.6. Sistemi zgjedhor i zbatuar në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2021

Edhe për zgjedhjet e vitit 2021, kuadri ligjor përbëhej nga Kushtetuta e 1998-ës (KShq), Kodi Zgjedhor i 2008-ës, që të dy të ndryshuar për herë të fundit në vitin 2020, si dhe nga akte të tjera ligjore dhe nën-

ligjore në këtë fushë.[104] Shqipëria është palë në disa instrumente të rëndësishme ndërkombëtare ligjore për zgjedhjet. Që nga rënia e komunizmit, Shqipëria është bërë palë në disa instrumente të rëndësishme ndërkombëtare ligjore për zgjedhjet, të cilat çdo herë kanë pasur relevancë.[105]

Kushtetuta garanton liri themelore dhe Kodi Zgjedhor shërben si bazë e përshtatshme për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike. Megjithatë, disa paqartësi dhe mungesa e konsistencës në ligj, duke përfshirë edhe ato që u shkaktuan nga ndryshimet e fundit, e cenojnë sigurinë juridike dhe administrimin efiçent të zgjedhjeve.[106] Përveç kësaj, Misioni i Kufizuar i Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MKVZ) i ODIHR-it vuri re disa raste interpretimesh tejet të zgjeruara të legjislacionit, duke përfshirë edhe nga KQZ-ja në miratimin e akteve nënligjore, duke çuar shpesh në rregullime më strikte.[107] Disa bashkëbisedues të MKVZ-së së ODIHR-it, duke përfshirë edhe në KQZ, u shprehën se ndryshimet e fundit në Kodin Zgjedhor krijuan një sërë paqartësish dhe ngritën shqetësime rreth kapacitetit teknik për zbatimin e tyre, sidomos në kohën e shkurtër mes ndryshimeve dhe zgjedhjeve.

Pas një procesi të hapur, gjithëpërfshirës dhe të mirëplanifikuar, parlamenti, me mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar, miratoi një sërë ndryshimesh në Kodin Zgjedhor më 23 korrik 2020. Këto ndryshime parashikuan të tjera garanci rregullatore kundër shpërdorimit të burimeve publike dhe forcuan garancitë për ekuilibrin gjinor në listat e kandidatëve, duke adresuar rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it. Këto ndryshime çuan edhe në ndryshime në strukturën e KQZ-së dhe në lidhje me procedurën e verifikimit të nominimit të kandidatëve, financimin publik dhe privat të fushatës, mbikëqyrjen e mbulimit të fushatës në media, si dhe në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore. Reforma parashikoi gjithashtu edhe identifikimin elektronik të zgjedhësve në ditën e votimit, mundësinë e futjes së votimit nga jashtë vendit, si dhe të pilotimit të teknologjive të reja të votimit dhe të numërimit.

Më 30 korrik 2020, me ndryshimet që u bënë në **KShq**, u fut në përdorim votimi preferencial. Më pas, me ndryshimet e bëra në Kodin Zgjedhor më 5 tetor – zëvendësimi i pragut rajonal që u duhej kandidatëve të kalonin për t'u kualifikuar për marrjen e një mandati me një prag kombëtar prej 1% – u parashikua një numër minimal kandidatësh në listat e partive dhe drejtuesit e partive politike dhe koalicioneve u lejuan që të kandidojnë deri në katër zona zgjedhore.[108] Në Opinionin e tyre të Përbashkët, Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës dhe ODIHR-i shprehën keqardhje që procedurat e miratimit të ndryshimeve në Kushtetutë dhe në Kodin Zgjedhor kishin qenë jashtëzakonisht të nxituara dhe që nuk ishin paraprirë nga një proces i duhur konsultimi. Ata vunë gjithashtu në dukje se ndryshimet në lidhje me numrin minimal të kandidatëve përbëjnë disavantazh për partitë më të vogla dhe se mundësia që u jepet drejtuesve të partive që të kandidojnë në disa zona zgjedhore njëherësh përbën

104 Duke përfshirë edhe Ligjin e vitit 2000 për Partitë politike, Ligjin e vitit 2001 për Demonstrimet, Ligjin e vitit 2013 për Mediat Audio-Vizive, Ligjin e vitit 2015 për Garantimin e Integritetit të Personave të Zgjedhur, të Emëruar ose që Ushtrojnë Funksione Publike (i ashtuquajturi Ligji i Dekriminalizimit), si dhe Ligjin e vitit 2008 për Barazinë Gjinore. KQZ-ja miraton akte nënligjore në zbatim të ligjeve.

105 Këtu hyn Konventa Ndërkombëtare e vitit 1966 për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR), Konventa Ndërkombëtare e vitit 1965 për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial, Konventa e OKB-së e vitit 1979 për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, Konventa e OKB-së e vitit 2003 kundër Korrupsionit, Konventa e vitit 2006 për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, si dhe Konventa Evropiane e vitit 1950 për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Shqipëria është anëtare e Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës dhe Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO).

106 Për shembull, neni 145 (2) i Kodit Zgjedhor i referohet një versioni të vjetër të nenit 24, i cili është hequr me ndryshimet e korrikut të 2020-ës; kufizimi i të drejtës së votës personave me aftësi të kufizuar intelektuale ose psikosociale u hoq nga neni 44 i Kodit Zgjedhor, por mbetet në Kushtetutë (neni 45) dhe në nenin 53 të Kodit Zgjedhor.

107 Vendimi Nr. 9 i Rregullatorit përcakton aktivitetet e ndaluara të institucioneve publike, si aktivitete që, *inter alia*, bëjnë publicitetin e shpenzimeve të fondeve shtetërore ose të buxheteve vendore për të cilat janë caktuar ose që janë miratuar në periudhën 4-mujore para zgjedhjeve, kurse Kodi Zgjedhor i referohet "të gjitha aktiviteteve me natyrë publike" pa iu referuar aspak fondeve të sipërpërmendura. Neni 10 i Vendimit Nr. 11 të Rregullatorit, në lidhje me formimin e KQV-ve parashikon që anëtarët e KQV-ve të mund të zëvendësohen me kërkesë të subjektit zgjedhor që i ka propozuar, ndërkohë që Kodi Zgjedhor nuk e parashikon këtë.

108 Edhe ndryshimet e tetorit 2020 në Kodin Zgjedhor parashikonin që njëra parti politike në koalicion duhet të marrë rolin drejtues dhe saktësonin disa procedura zgjedhore. Në nëntor 2020, u miratuan disa ndryshime në Ligjin për Partitë Politike për ta harmonizuar atë me Kodin Zgjedhor.

shkelje të së drejtës së kandidimit në kushte të barabarta.[109]

Kuvendi prej 140 u zgjodh më 25 prill 2021, për një mandat katër-vjeçar, përmes një sistemi proporcional rajonal. Kandidatët u zgjodhën edhe këtu nga 12 zona zgjedhore që përkojnë me qarqet administrative, përmes listave shumë-emërore të kandidatëve. Numri i mandateve që i takon secilit qark edhe në këto zgjedhje varej nga numri i shtetasve të regjistruar në të dhe garantoi në përgjithësi barazinë e votës.[110] Votimi preferencial brenda listave të partive, i futur me ndryshimet e fundit, i jep mundësi zgjedhësit që të ndikojë në renditjen e kandidatëve në listë.

Për t'u kualifikuar për marrjen e një mandati në Kuvendin e Shqipërisë, subjektet zgjedhore, duke përfshirë edhe kandidatët e pavarur, duhej të kalonin një prag tjetër zgjedhor nga zgjedhjet paraprake: tani ai ishte një përqind në shkallë vendi. Zbatimi i këtij pragu për kandidatët e pavarur ka bërë që ata, për të hyrë në Kuvend, duhej të merrnin një numër votash ndjeshëm më të lartë sesa kandidatët e partive në zonat elektorale përkatëse. Kështu, aplikimi i një pragu kombëtar prej 1% për kandidatët e pavarur mund të ketë sfiduar parimin e kandidimit në kushte të barabarta.

10.2. Tiparet e sistemeve elektorale në Shqipëri

Ai çka është tipari më i dukshëm i sistemeve elektorale të zbatuara në Shqipëri është ndryshimi sistematik i tyre. Në çdo palë zgjedhje në Shqipëri janë zbatuar sisteme elektorale të ndryshme apo të ngjashëm me modifikimet përkatëse brenda formulave zgjedhore. Gjatë këtyre viteve post-periudhës komuniste Shqipëria ka aplikuar sistem mazhoritar me dy raunde, sistem miks të varur, sistem miks të pavarur, sistem proporcional rajonal, sistem miks ku dimensioni mazhoritar përcaktohet nga modeli mazhoritar me dy raunde në disa raste apo me shumicë minimale siç është rasti i zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2005.

Po ashtu në zgjedhje të ndryshme kemi aplikuar dhe numër të ndryshëm deputetësh në parlament, 250 në 1991, 140 në 1992 dhe në 1996, 155 në 1997, dhe 140 pas vitit 1998 me miratimin e Kushtetutës së Shqipërisë. Vihet re si tendencë ndër vite se ka një zhvendosje në kuadrin e familjeve të sistemeve elektorale nga ato tipike mazhoritare drejt atyre më proporcionale. Ndryshimi kaq i shpeshtë i sistemit ka ofruar produkte politike të ndryshme të cilat rrezatohen në gjithë sistemin politik, dhe në modelin e demokracisë që zbaton Shqipëria.

Sisteme të ndryshme elektorale na kanë dhënë mundësi të eksperimentojmë me modele të ndryshme opozicioni dhe mazhorancash nga ato më të fuqishmet deri tek ato më të brishtat dhe të kushtëzuarat.

Një element i tjetër i dukshëm i sistemeve të përdorura në Shqipëri është fakti se me përjashtim të zgjedhjeve të vitit 2009, në gjithë zgjedhjet e mëparshme të paktën 100 deputetë në Kuvendin e Shqipërisë janë zgjedhur nëpërmjet formulave mazhoritare (shumicë minimale apo mazhoritare me dy raunde). Ky është një fakt i rëndësishëm për të kuptuar një vazhdueshmëri pothuaj 15-vjeçare si në konkurrimin e partive politike (sprova për të konkurruar si kandidat kundër kundërshtarit) ashtu dhe në krijimin e një modeli familjar për votuesit (votimi për kandidat).

---

109 Shih **Opinionin e Përbashkët të vitit 2020 të Komisionit të Venecias dhe ODIHR-it**: Opinion No. 1006 / 2020 ODIHR Opinion Nr ELE-ALB/396/2020 CDL-AD(2020)036 Or. Engl. EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION) OSCE OFFICE FOR DEMOCRATIC INSTITUTIONS AND HUMAN RIGHTS (OSCE/ODIHR) ALBANIA JOINT OPINION ON THE AMENDMENTS TO THE CONSTITUTION OF 30 JULY 2020 AND TO THE ELECTORAL CODE OF 5 OCTOBER 202. Në internet: https://www.osce.org/files/f/documents/7/2/473655.pdf (shikuar më 3 tetor 2022).

110 Në dhjetor të vitit 2020, Rregullatori vendosi për ndarjen e mandateve sipas qarqeve. Për shkak të demografisë, Tirana mori edhe dy mandate, kurse Dibra dhe Gjirokastra humbën që të dyja nga një mandat, krahasuar me zgjedhjet parlamentare të 2017-ës. Dy nga 12 qarqe e tejkalojnë shmangien prej 10 për qind nga numri mesatar i qytetarëve për mandat, ku qarku i Gjirokastrës dhe ai i Kukësit kanë përkatësisht një shmangie prej 13.7 dhe 13.0 për qind qytetarë më shumë për mandat. Kjo është në përputhje me praktikën e mirë zgjedhore.

Me ndryshimet kushtetuese të vitit 2008 u vendos kalimi në sistemin proporcional rajonal, me lista të mbyllura dhe me prag minimal zgjedhor 3%. Me ndryshimet kushtetuese të vitit 2020 u vendos ulja e pragut elektoral në 1% dhe aplikimi për herë të parë i listave të hapura proporcionale. Shqipëria ka eksperimentuar disa herë me prag të ndryshëm elektoral: nga zgjedhje pa prag elektoral (1991) në zgjedhje me prag minimal 2%, 2.5%, 4%, 3% dhe së fundi, në zgjedhjet e vitit 2021 me prag 1%.
Numri i deputetëve ka ndryshuar vetëm në dy raste: më 1991 u ruajt numri i deputetëve i legjislaturave të fundit të periudhës komuniste (250 deputetë), si dhe më 1997 u ruajt sistemi i vitit 1996 me rritjen e numrit të deputetëve në proporcional nga 25 në 40 vende, për pasojë, parlamenti kishte 155 deputetë.

Shqiptari si votues në dimensionin politik të tij vjen në fillimin e viteve 90', vjen pa kujtesë dhe përvojë me liberal demokracinë dhe konceptet bazike politike liberale. Ai vjen i pasur në përvojë me modelin e partisë shtet, ku roli i tij në vendimmarrjen e madhe politike është pasiv, ku pjesëmarrja politike reflektohet në nivelin e gëlltitjes dhe brendësimin e ideologjisë së kohës. Vjen me një eksperiencë ku e ndryshmja ideore ndëshkohet, klasifikohet si armiqësore dhe që duhet asgjësuar. Ajo çka është e rëndësishme të theksohet, është se **nuk ka një sistem elektoral që të garantojë maksimalisht gjithë dimensionet ideale**, kështu që zgjedhja duhet të reflektojë një kompromis dhe interesat më thelbësore të shoqërisë.

Pyetja themelore që shtrohet, atëherë, është se për çfarë është votuar në zgjedhjet parlamentare shqiptare deri më sot? Në përvojën zgjedhore 1991-2021, me ndryshimet në sistemin e votimit ka ndryshuar edhe mënyra e votimit të qytetarëve. Më 1991 zgjedhësi nuk votonte partinë në fletën e votimit, por emrin e kandidatit të propozuar nga partitë/subjektet politike. Midis 1992-2005 është votuar për partinë dhe për kandidatin, pra me dy fletë votimi. Pas 2008 deri më 2019 është votuar vetëm për partinë politike me një fletë votimi. Më 2021 do të votohet për partinë dhe kandidatin e preferuar në listën e saj.

Zgjedhjet e viteve 1992-2001 kanë qenë me dy raunde në votimin mazhoritar. Më 2005 u aplikua sistemi me një raund në mazhoritar. Pas 2008 nuk ka raund votimi, për shkak se nuk ka votim rivalizues midis kandidatëve, për rrjedhojë është votuar vetëm për partinë politike.

10.3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe administrimi i zgjedhjeve

Struktura e KQZ-së (përbërja, mandati dhe zgjedhja) kanë ndryshuar shumë herë gjatë tranzicionit. Midis viteve 1991-1998, KQZ-ja emërohej nga Presidenti dhe Këshilli i Ministrave dhe ishte organ i përkohshëm vetëm për periudhën zgjedhore. Në vitin 1998, **KShq** e shndërroi KQZ-në në organ kushtetues dhe përcaktoi zgjedhjen e tij nga organe kushtetuese. Një ndërhyrje tjetër në **KShq** (2007) solli ndryshime në përbërje, por në vitin 2008 ndryshimet kushtetuese e zhvendosën KQZ-në nga organ kushtetues në organ administrativ që funksionon mbi bazën e Kodit Zgjedhor.

Reforma zgjedhore 2020 aplikoi për herë të parë krijimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve si organ monokratik, si dhe ndryshimin thelbësor të strukturës së KQZ-së. Pas ndryshimeve të vitit 2020 KQZ-ja do të përbëhet nga tri organe:

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (me mandat 7-vjeçar, zgjedhur nga Kuvendi);
- Komisioni Rregullator (5 anëtarë me mandat 5- vjeçar, zgjedhur nga Kuvendi); dhe
- Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (5 anëtarë me mandat 9-vjeçar, zgjedhur nga Kuvendi).

Posti i Nënkomisionerit është me mandat 4-vjeçar, zgjedhur nga Kuvendi.

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ) - Është organ kolegjial, ngrihet dhe funksionon për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore dhe ato për Kuvendin. Prej vitesh administrimi zgjedhor është bazuar në balancimin politik midis mazhorancës dhe opozitës. Me gjithë kritikat dhe rekomandimet e OSBE/ODIHR kjo përbërje nuk ka ndryshuar as për zgjedhjet e vitit 2021: KZAZ do

të kenë 7 anëtarë (2 nga PS, 2 nga PD, 1 nga partia e dytë në qeveri dhe 1 nga partia e dytë në opozitë, 1 në raportet 50% nga Partia Socialiste dhe Partia Demokratike). KZAZ-të emërohen nga KQZ-ja dhe 30% e anëtarëve duhet të jenë nga secila gjini.

Komisioni i Qendrave të Votimit (KQV) - është organ kolegjial dhe përbëhet nga shtatë anëtarë, ku një anëtar ushtron detyrën e sekretarit, të cilët emërohen nga KZAZ-ja vijojnë të jenë me përfaqësues politikë, sipas formulës së KZAZ-ve. Përgjigjet për zhvillimin e zgjedhjeve në qendrën e votimit dhe zbaton detyrat e parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore të nxjerra nga KQZ-ja, KZAZ-ja.

Grupet e numërimit të votave (GNV) përbëhen nga katër anëtarë, të cilët caktohen me vendim të KZAZ-së. Ata numërojnë votat në rang të zonës së administrimit zgjedhor (ZAZ) dhe nxjerrin rezultatin e zgjedhjeve për çdo qendër votimi të bashkisë përkatëse për kryetarin e bashkisë dhe këshillin bashkiak. Dy anëtarë janë nga mazhoranca e dy nga opozita në GNV.

10.4. Vota e diasporës në zgjedhjet e vitit 2021

Shqipëria i garanton të drejtën e votës shtetasve të vet që duan të votojnë brenda territorit të vendit. Deri më 2020, shqiptarët jashtë vendit mund të udhëtonin dhe të votonin në Shqipëri. Me ndryshimet në Kodin Zgjedhor (2020) krijohet baza ligjore që shtetasit shqiptar, me banim jashtë territorit të Shqipërisë, të votojnë në vendet ku ndodhen jashtë shtetit.
KQZ-ja miraton rregullat për regjistrin e votuesve jashtë vendit, për procedurat e tyre të votimit, për administrimin dhe numërimin e votave nga jashtë vendit dhe përfshirjen e tyre në rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve për Kuvendin. Organi Rregullator në KQZ, ndërkaq, shqyrton dhe miraton projekt-aktet e përgatitura nga administrata e KQZ-së për zhvillimin për herë të parë të votimit nga jashtë vendit, mbështetur në raportimin e Komisionerit për plotësimin e masave tekniko-organizative që mundësojnë votimin.

Procedurat e detajuara të votimit nga jashtë vendit miratohen me akt normativ të KQZ-së, kurse votat e votuesve nga jashtë vendit administrohen nga KQZ, duke garantuar integritetin e votimit dhe fshehtësinë e votës nga çdo ndërhyrje mbi fletët e votimit ose mbi informacionin elektronik të votimit që administrohet prej saj.

10.5. Caktimi i numrit të mandateve dhe zonave zgjedhore

Zonat zgjedhore organizohen në përputhje me ndarjen administrative në Shqipëri. Prej vitit 2008, Shqipëria ka 12 zona zgjedhore me numër të ndryshëm banorësh dhe mandatesh parlamentare.

Katër muaj përpara zgjedhjeve KQZ, mbi bazën e listës së zgjedhësve, bën përllogaritjen dhe miratimin e numrit të mandateve për çdo zonë. Numri total i shtetasve pjesëtohet me numrin 140 të mandateve të Kuvendit, duke përcaktuar numrin mesatar të shtetasve që i takojnë çdo mandati të Kuvendit. Numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore përcaktohet duke pjesëtuar numrin e shtetasve me vendbanim në zonën zgjedhore, me numrin mesatar.

Në zgjedhjet parlamentare 2017 qarku Kukës, Berat dhe Korçë humbën nga një mandat, të cilat iu shtuan qarkut Tiranë (2) dhe Durrës (1). Në zgjedhjet parlamentare 2021, sikundër i tha, qarku Dibër dhe Gjirokastër humbën nga 1 mandat, për t'iu shtuar qarkut Tiranë.

10.6. Përfaqësimi gjinor

Kurba e përfaqësimit gjinor ka ndryshuar pozitivisht në zgjedhjet parlamentare. Më 1991 gratë deputete zinin vetëm 4% të vendeve në parlament, më 1992, 2001 dhe 2005 gjithashtu ato patën raporte minimale përfaqësimi (6-7%), por pas vitit 2019 dhe aplikimit të sistemit proporcional me

lista të mbyllura përqindja u rrit ndjeshëm. Në zgjedhjet e vitit 2009 gratë deputete zinin 16%, më 2013 arritën në 29% dhe më 2017 në 26%.

Ndryshimet ligjore të vitit 2020 kanë sjellë një bazë të re mbi përfaqësimin gjinor në Shqipëri. Sipas Kodit Zgjedhor, mospërmbushja nga subjekti zgjedhor i detyrimit për respektimin e 30% të kuotës gjinore në listën shumë-emërore rezulton në refuzimin e listës shumë-emërore për t'u regjistruar në KQZ ose, sipas rastit, për zgjedhjet vendore në KZAZ. Në këtë mënyrë, synimi për vendosjen e kuotës minimale gjinore 30% të përbërjes së Kuvendit të Shqipërisë merr një mbështetje të re dhe mund të rezultojë me efektive sesa baza e mëparshme ligjore. Kodi Zgjedhor detyron subjektet politike të respektojnë parimet e përfaqësimit gjinor edhe në përbërjen e KZAZ-ve.

10.7. Ndarja e mandateve në zgjedhjet parlamentare

Pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit KQZ-ja përllogarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt. Shpërndarja e mandateve fillon me rend zbritës, në bazë të renditjes së tyre në listën e dorëzuar, duke filluar nga numri rendor një, si dhe numrit të votës parapëlqyese të secilit kandidat bazuar në procedurat dhe kriteret vijuese. Në fillim përfitojnë mandat kandidatët që kanë marrë një numër votash parapëlqyese më të madh se herësi që del nga pjesëtimi i numrit të votave të subjektit me numrin e mandateve të fituara nga subjekti. Në çdo rast, herësi nuk mund të jetë më shumë se 10 000 vota. Në rast se herësi që përftohet nga pjesëtimi është një numër me mbetje dhjetore, si herës merret numri i plotë më i afërt.

Kandidatët me numrin më të lartë të votave parapëlqyese se herësi, zëvendësojnë me radhë kandidatët në listë, që mund të kishin përfituar mandate, të cilët kanë numrin më të vogël të votave parapëlqyese. Ky rregull nuk zbatohet nëse kandidati me më pak vota i përket gjinisë më pak të përfaqësuar. Në këtë rast zëvendësimi kalon te kandidati tjetër i renditur menjëherë më lart me numër votash deri në shterimin e listës sipas të njëjtave kritere.

10.8. Vëzhgues në zgjedhje

Kodi Zgjedhor i njeh të drejtën e caktimit të vëzhguesve në zgjedhje:

- Çdo partie politike të regjistruar në KQZ;
- Çdo kandidati të propozuar nga zgjedhësit;
- Çdo subjekti zgjedhor të regjistruar në KQZ;
- Çdo organizate joqeveritare të regjistruar në KQZ; dhe
- Çdo organizate ndërkombëtare të regjistruar në KQZ.

Vëzhguesit e subjekteve në zgjedhje kanë të drejtë të marrin kopje të dokumentacionit zgjedhor, përfshirë kopje të procesverbaleve dhe rezultateve finale të zgjedhjeve. Media ka të drejtë dhe qasje të plotë të monitorojë të gjithë procesin dhe të raportojë mbi nivelin e jetësimit të standardeve të tyre. Media duhet të jetë e paanshme dhe e balancuar në informim.

10.9. Kolegji Zgjedhor

Kolegji Zgjedhor është organi më i lartë gjyqësor përgjegjës për shqyrtimin dhe vendimmarrjen lidhur me çështjet zgjedhore. Kolegji është krijuar me ndryshimet në Kodin Zgjedhor të vitit 2003 dhe ka funksionuar në zgjedhjet parlamentare e vitit 2005, 2009, 2013 dhe 2017.

Kolegji Zgjedhor përbëhet nga 8 gjyqtarë të përzgjedhur me short nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, nga radhët e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses, me vendim të formës së prerë, procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve (vetingun). Ata zgjidhen nga gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apelit, gjykatat administrative të shkallës së parë dhe Gjykata Administrative e Apelit Tiranë. Përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit. Mandati i Kolegjit Zgjedhor është 4 vjet (sa legjislatura parlamentare) dhe anëtarët e tij gëzojnë imunitet të veçantë lidhur me hetimin, transferimin dhe sistemin e karrierës. Kolegji Zgjedhor ka qenë vendimmarrës edhe në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021.

10.10. Zgjedhjet lokale

Zgjedhjet lokale janë zhvilluar për herë të parë në korrik 1992. Prej atëherë janë zhvilluar 8 procese zgjedhore të zgjedhjeve lokale në nivel kombëtar. Mandatet e qeverisjes lokale kanë ndryshuar nga 4 vite (1992-2000 dhe pas 2008) në 3 vite (2000-2008). Gjithashtu, kanë ndryshuar edhe institucionet e qeverisjes lokale që zgjidhen direkt ose indirekt në ditën e votimit. Prej vitit 2014 ndarja e re territoriale nuk ka më komuna, ndaj votohet vetëm për kryetarin e bashkisë dhe këshillin bashkiak.

Edhe në këto zgjedhje, vota është proporcionale. Zgjedhjet e fundit lokale të vitit 2019 janë bojkotuar nga partitë e opozitës, për pasojë nuk përbëjnë burim reference në rezultatet zgjedhore, ndërsa Lëvizja Socialiste për Integrim konkurroi për herë të parë më 2007 dhe Fryma e Re Demokratike më 2015.

Në Shqipëri zgjedhjet lokale zhvillohen në të njëjtën ditë në nivel kombëtar. Nga mënyra sesi zhvillohet fushata elektorale dhe organizimi i tyre zgjedhjet lokale ngjasojnë me zgjedhjet politike parlamentare.

Sistemi mazhoritar i votimit për kryetarët e bashkive vijon të jetë me një raund që prej vitit 2003. Pjesëmarrja në zgjedhjet lokale ka diferencë me pjesëmarrjet në zgjedhjet parlamentare. Pjesëmarrja më e lartë është shënuar më 1992 (70%) dhe më e ulët më 2019 (22%).

11. Zgjedhjet në Maqedoninë e Veriut

11.1. Pasqyrë e zgjedhjeve të deritanishme parlamentare

Për prodhimin e këtij seksioni lidhur me të drejtën zgjedhore dhe zgjedhjet në Maqedoninë e Veriut (MV) kemi përdorur një literaturë klasike të së drejtës kushtetuese maqedone, por edhe materiale të tjera dhe hulumtime të sektorit privat që kanë përcjellë dhe hulumtuar zgjedhjet në **MV** në të gjitha nivelet.[111] Parimet themelore të zgjedhjeve parlamentare janë të rregulluara me **Kushtetutën e MV** (KMVe),

[111] Etem Aziri, "Izborni sistemi i izboriu Republici Makedoniji:prošlost, sadašnjost iizazovi za budućnost". Politicke Perspektive: casopis za istrazivanje politike. Vol. 3 No. 1 (2013) fq. 7-21; Svetomir Skaric, *Ustavno pravo* (Kultura: Skopje, 2015) (vetëm në gjuhën maqedone, alfabeti cirilik); *Manual për zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë 2017*. Edicioni i dytë i përditësuar (Konrad Adenauer Stiftung dhe Instituti për Demokraci "Societas Civilis": Shkup, 2017); Subhi Jakupi, *Rregllativa dhe parregullsitë zgjedhore* (Instituti për Studime Politike dhe Ndërkombëtare: Shkup, 2017); Muaz Agushi, "Historiku i zgjedhjeve parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut (1990-2020)". *Institute for Security Studies and Development. North Macedonia*. 6, 10 dhe 13 korrik 2020. Në internet:https://cssd-ngo.org/hihitoriku-i-zgjedhjeve-parlamentare-ne-republiken-e-maqedonise-se-veriut-19902020h / (shikuar më 4 tetor 2022); *Manual për zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2020* (Konrad Adenauer Stiftung dhe Instituti për Demokraci "Societas Civilis": Shkup, 2020); IFIMES, *Parlamentarni izboru u Sjevernoj Makedoniji 2020: Članstvo u NATO-u historijski uspjeh* (9/12/22). Në internet: https://www.ifimes. org/ba/ istrazivanja/parlamentarni-izboru-u-sjevernoj-makedoniji-2020-clanstvo-u-nato-uhistorijski-uspjehparlamentarni-izb ori-vo-severna-makedonija-2020-clenstvoto-vo-nato-kako-istoriski-uspex/4606 (shikuar në 4 tetor 2022); *SISTEMI ZGJEDHOR I MAQEDONISË SË VERIUT–SI TË SIGUROHET PËRFAQËSIMI I DREJTË NË PARLAMENT* (Instituti Nacional Demokratik: Shkup, 2022).

ndërsa mënyra, kushtet dhe procedurat për zgjedhje të deputetëve janë të rregulluara me Kodin Zgjedhor.

Në pjesën e mëposhtme është paraqitur në mënyrë të përmbledhur sistemi elektoral i zbatuar në disa prej zgjedhjeve të përgjithshme të mbajtura, për të kaluar më pas në trajtimin e sistemit elektoral për zgjedhjet lokale dhe për Presidentin e Republikës së **MV**, i cili zgjidhet drejtpërdrejt.

11.1.1. Sistemi elektoral për zgjedhjet në Kuvendin Popullor në vitin 1990

Pas instalimit të pluralizmit politik, me ndryshimet kushtetuese të vitit 1989, me çka u mundësua formimi i partive politike, votuesit e Republikës së MV, për herë të parë patën mundësi të votojnë në zgjedhjet shumëpartiake në vitin 1990, në Republikën e atëhershme Socialiste të Maqedonisë (RSM). Njëkohësisht, ato ishin edhe zgjedhjet e para të lira shumëpartiake të cilat gjatë vitit të njëjtë u zhvilluan në të gjitha gjashtë republikat e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ). Zgjedhjet u zhvilluan sipas sistemit zgjedhor mazhoritar me shumicë absolute (në rrethin e parë) dhe shumicë relative (në rrethin e dytë). Deputetët janë zgjedhur në bazë të parimit: një mandat deputeti – një njësi zgjedhore, ku territori i MV u nda në 120 njësi zgjedhore. Në rrethin e parë, nga gjithsej 1.339.021 votues të regjistruar, në zgjedhje dolën 84,8% ndërsa në rrethin e dytë 76,8%. Mandate në Kuvend fituan nëntë parti dhe tre deputetë të pavarur. Për shkak të parregullsive të konstatuara, u anuluan zgjedhjet në 176 vende zgjedhore, nga 33 njësi zgjedhore në 14 komuna.

11.1.2. Sistemi elektoral për zgjedhjet në Kuvendin Popullor në vitin 1994

Zgjedhjet e para parlamentare pas pavarësimit të **MV**, u mbajtën në muajin tetor të vitit 1994 së bashku me zgjedhjet e para presidenciale. Në zgjedhje morën pjesë 38 parti politike dhe 283 kandidatë të pavarur. Edhe këto zgjedhje u zhvilluan sipas sistemit zgjedhor mazhoritar me shumicë absolute (në rrethin e parë) dhe shumicë relative (në rrethin e dytë), ku deputetët janë zgjedhur në bazë të parimit: një mandat deputeti – një njësi zgjedhore dhe i gjithë territori u nda në 120 njësi zgjedhore. Në këto zgjedhje të drejtë vote kishin 1.360.729 votues. Në rrethin e parë i cili u mbajt më 16 tetor, pjesëmarrja në votim ishte 77.8% ndërkaq në rrethin e dytë i cili u mbajt me 30 tetor, dolën 57.7% të votuesve.

11.1.3. Sistemi elektoral për zgjedhjet në Kuvendin Popullor në vitin 1998

Në këto zgjedhje sistemi zgjedhor u ndryshua. Në vend të sistemit mazhoritar, zgjedhjet u mbajtën sipas **sistemit të përzier zgjedhor**. Nga 120 mandate, 85 deputetë janë zgjedhur sipas modelit mazhoritar që u shpërndanë në 85 njësi zgjedhore, për të cilat u votua më 18 tetor, ndërkaq 35 mandatet e tjera sipas sistemit proporcional me **metodën e D'Hontit**, ku i tërë shteti ishte një njësi zgjedhore u mbajtën më 1 nëntor. Për listat proporcionale u fut pragu zgjedhor prej 5%.

Nga gjithsej 1.572.976 votues të regjistruar për këto zgjedhje, për listat mazhoritare në votim dolën 1.146.505 apo 72,9% ndërsa 34.183 ishte numri i fletëvotimeve të pavlefshme. Dalja për listën proporcionale në rrethin e dytë nga gjithsej 1.124.878, në votim dolën 786.246 apo 69,9%. Për listat mazhoritare me kandidatë të tyre dolën 22 parti politike, 4 koalicione dhe 7 kandidatë të pavarur. Në listat proporcionale garonin 12 parti, 4 koalicione dhe një grup zgjedhësish. Këto ishin zgjedhjet e para në Maqedoni të monitoruara nga misioni i OSBE/OHDIR.

11.1.4. Sistemi elektoral për zgjedhjet në Kuvendin Popullor në vitin 2002

Më 15 shtator të vitit 2002 në një atmosferë të tensionuar pas konfliktit të vitit 2001 u zhvilluan zgjedhjet e radhës. Karakteristikë e këtij cikli zgjedhor është se në skenën politike të bllokut politik shqiptar u paraqit një subjekt i ri Bashkimi Demokratik për Integrim i formuar nga disa udhëheqës të **Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare**.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2002 u aplikua modeli proporcional për ndarjen e të gjitha 120 vendeve të deputetëve. Territori i Republikës së **MV** u nda në gjashtë njësi zgjedhore, kurse nga çdo njësi zgjedhore zgjodhën nga 20 deputetë. Gjithsej 38 parti, koalicione partiake dhe kandidatë të pavarur u regjistruan në listat e kandidatëve në një ose më shumë nga gjashtë njësi zgjedhore. Nga gjithsej 1.664.296 votues të regjistruar, në zgjedhje dolën 73,4%.

11.1.5. Sistemi elektoral për zgjedhjet në Kuvendin Popullor në vitin 2006

Në këto zgjedhje të cilat u mbajtën më 5 qershor të vitit 2006, u shënua jehonë më e ultë, nga gjithsej 1.741.449 votues të regjistruar, në zgjedhje dolën vetëm 56%. Këto zgjedhje, sikurse edhe ato paraprake, u zhvilluan sipas modelit zgjedhor proporcional për ndarjen e të gjitha 120 vendeve të deputetëve, ku territori i Republikës së **MV** u nda në gjashtë njësi zgjedhore. Nga çdo njësi zgjedhore u zgjidhen nga 20 deputetë. Gjatë këtyre zgjedhjeve kishte edhe rivotim në 29 vendvotime në njësitë zgjedhore 1,5 dhe 6 të cilat u zhvilluan më19 korrik 2019.

Për pjesëmarrje në zgjedhjet e vitit 2006 u paraqitën 33 lista të kandidatëve, prej të cilave 31 nga partitë politike dhe koalicionet dhe 2 nga grup zgjedhësish. Njëmbëdhjetë parti dhe koalicione morën pjesë në garën zgjedhore në gjashtë njësi zgjedhore, shtatë parti dhe koalicione paraqitën listat e kandidatëve për deputetë në pesë njësi zgjedhore. Katër parti dhe dy grupe zgjedhësish paraqitën listat e tyre të kandidatëve në vetëm një njësi zgjedhore.

11.1.6. Sistemi elektoral për zgjedhjet në Kuvendin Popullor në vitin 2008

Dy vjet pas fitimit të pushtetit, në pajtim me **KMVe**, Kuvendi i MV votoi shpërbërjen e vet më 12 prill 2008 dhe shpalli zgjedhje të parakohshme të cilat i caktoi më 1 qershor 2008. Këto ishin edhe zgjedhjet e para të parakohshme parlamentare në Maqedoninë e pavarur. Zgjedhjet u zhvilluan sipas modelit zgjedhor proporcional për ndarjen e të gjitha 120 vendeve të deputetëve, ku territori i Republikës së MV u nda në gjashtë njësi zgjedhore, kurse nga çdo njësi zgjedhore u zgjodhën nga 20 deputetë. Në votim dolën 75,06% nga gjithsej 1.779.116 qytetarë të regjistruar me të drejtë vote. 2 koalicione, 16 parti politike dhe 2 kandidatë të pavarur kishin parashtruar listat e kandidatëve për regjistrim në **KSHZ**. Pas shqyrtimit të hollësishëm të ankesave nga ana e Komisionit Shtetëror Zgjedhor, më 15 qershor, zgjedhjet u përsëritën në 187 vendvotime, dhe më pastaj, më 29 qershor, edhe në 15 vendvotime.

Në përgjithësi, zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 2008-ës nuk i plotësuan obligimet kyçe të OSBE-së.

11.1.7. Sistemi elektoral për zgjedhjet në Kuvendin Popullor në vitin 2011

Zgjedhjet e 5 qershorit të vitit 2011 ishin zgjedhjet e dyta të parakohshme parlamentare që nga pavarësimi i MV dhe zgjedhje të dyta të këtilla të njëpasnjëshme. Më 14 prill parlamenti miratoi shpërbërjen e tij dhe i shpalli zgjedhjet parlamentare të parakohshme më 5 qershor. Në këto zgjedhje u rrit numri i njësive zgjedhore nga 6 në 9: njëra në Evropë dhe Afrikë, njëra për Amerikën Veriore dhe Jugore dhe njëra për Australi dhe Azi. Me këtë u përfshinë edhe votuesit e diasporës. Për shkak të mundësimit të votimit për diasporën u bë një modifikim i vogël i modelit zgjedhor. Kështu, në 6 njësitë zgjedhore, në

territorin e **MV** kandidatët u zgjodhën sipas modelit proporcional, ndërsa për tri njësitë e reja jashtë vendit u aplikua modeli mazhoritar. Me këto ndryshime u rrit numri i vendeve në Kuvendin e **MV** nga 120 në 123, përkatësisht nga një deputet nga secila nga njësitë e reja zgjedhore. Shtetasit maqedonas, të cilët jetojnë jashtë vendit, votuan në përfaqësitë diplomatike konsullore. Pjesëmarrja në këto zgjedhje ishte 63,39% nga gjithsej 1.821.122 votues të regjistruar diku 29,000 më shumë se në zgjedhjet presidenciale dhe vendore në vitin 2009. 7.213 persona ishin regjistruar për të votuar jashtë vendit; 4591 në njësinë zgjedhore 7 i cili mbulon Evropën dhe Afrikën, 1824 në njësinë e tetë zgjedhore e përfshinë Amerikën Veriore dhe Jugore, dhe 798 në njësinë e tetë zgjedhore e cila mbulon Australinë dhe Azinë. Gjithsej, 1,679 kandidatë morën pjesë në këto zgjedhje, duke u ofruar kështu zgjedhësve një laramani opsionesh politike.

11.1.8. Sistemi elektoral për zgjedhjet në Kuvendin Popullor në vitin 2014

Më 27 prill 2014, u mbajtën zgjedhjet e teta parlamentare nga pavarësimi i **MV** ndërsa të tretat me radhë zgjedhje të parakohshme parlamentare. Zgjedhjet u mbajtën bashkë me rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale, të cilat u shpallën më 6 mars pasi që një ditë më parë, më 5 mars, deputetët unanimisht votuan për shpërndarjen e Kuvendit.

Nga gjithsej 1,780,128 votues të regjistruar votuan 62,96 %. Kandidatët për deputetë, si edhe në ciklin paraprak zgjedhor, zgjidheshin në 6 njësi zgjedhore në territorin e MV sipas modelit proporcional dhe në tri njësi jashtë vendit, sipas modelit mazhoritar. Deri në afatin e fundit lista të tyre me kandidatë paraqitën gjithsej 9 parti politike dhe 5 koalicione.

11.1.9. Sistemi elektoral për zgjedhjet në Kuvendin Popullor në vitin 2016

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 ishin zgjedhjet e nënta parlamentare që nga pavarësia e Republikës së MV, që i bëri zgjedhjet e katërta të parakohshme parlamentare deri më sot. Më 17 tetor, pas dy viteve krizë politike, parlamenti u shpërbë, për herë të dytë në vit. Zgjedhjet u mbajtën më 11 dhjetor 2016.

Në këto zgjedhje pjesëmarrja ishte e lartë. Nga 1.784 416 votues të regjistruar, kanë votuar 66.79%, që është pjesëmarrja më e lartë në katër zgjedhjet e fundit parlamentare nga viti 2006. Këto zgjedhje, u zhvilluan sipas modelit zgjedhor proporcional të përfaqësimit dhe përdorimit të listave të mbyllura me përdorimin e **metodës d'Hondt**, ku njëzet deputetë zgjidhen nga secila prej gjashtë njësive zgjedhore në vend dhe deri në tre deputetë prej një njësie zgjedhore jashtë vendit, që përfshinë vendet e Evropës, Afrikës, Amerikës së Veriut, Amerikës së Jugut, Australisë dhe Azisë. Deri në fund të afatit ligjor 11 nëntor, KSHZ-ja regjistroi 6 parti politike dhe 5 koalicione me gjithsej 1,092 kandidatë në 58 lista në njësitë zgjedhore 1,2,3,4,5 dhe 6, ndërsa në njësinë zgjedhore 7 u paraqitën katër lista me gjithsej 12 kandidatë.

11.1.10. Sistemi elektoral për zgjedhjet në Kuvendin Popullor në vitin 2020

Zgjedhjet parlamentare të 15 korrikut 2020 janë zgjedhjet e dhjeta parlamentare që nga pavarësia e Republikës së MV, e që janë zgjedhjet e pesta të parakohshme parlamentare. Deputetët zgjidhen sipas modelit zgjedhor proporcional me lista të mbyllura të deputetëve, gjithashtu me përdorimin e **metodës d'Hondt**, ku në secilën nga gjashtë njësitë zgjedhore, sipas të cilave është bërë ndarja e territorit të shtetit, zgjidhen nga 20 deputetë. Me ndryshimet e fundit në Kodin Zgjedhor të shkurtit 2020 u bë ristrukturimi i njësive zgjedhore, ku dy komuna (Dibër dhe Mavrovë-Rostushë) kanë kaluar nga njësia zgjedhore e gjashtë në atë të pestë. Në njësinë zgjedhore 7 për diasporën, në këto zgjedhje nuk u votua, pasi që numri i kërkesave të pranuara ishte më i ulët se numri i votave me të cilat është zgjedhur një anëtar i Kuvendit të MV që nga zgjedhjet e vitit 2016. Për pasojë, qytetarët kanë mund

të mundur të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës nëse votonin në qendrat e votimit në Republikën e MV. Në këto zgjedhje 1.814.263 qytetarët me të drejtë vote kanë pasur mundësinë të votojnë për 15 subjekte politike, pra 12 parti politike dhe tre koalicione.

11.2. Sistemi zgjedhor aktual në MV

Në Kuvendin e Republikës së MV deputeti zgjidhet në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë për një mandat 4-vjeçar. Në zgjedhjet parlamentare zgjidhen 120 – 123 deputetë, ndërsa sipas **KMVe**, Kuvendin mund ta përbëjnë nga 120 deri në 140 deputetë. Deputetët zgjidhen sipas modelit zgjedhor proporcional me lista të mbyllura të deputetëve, gjithashtu me përdorimin e **metodës d'Hondt**, ku në secilën nga gjashtë njësitë zgjedhore, sipas të cilave është bërë ndarja e territorit të shtetit, zgjidhen nga 20 deputetë. Sikundër u tha, me ndryshimet e fundit në **Kodin Zgjedhor** të shkurtit 2020 u bë ristrukturimi i njësive zgjedhore, ku dy komuna (Dibër dhe Mavrovë-Rostushë) kanë kaluar nga njësia zgjedhore e gjashtë në atë të pestë.[112]

Numri i zgjedhësve në territorin e shtetit mund të lëvizë më së shumti në kuadër të margjinës -/+5% në raport me numrin mesatar të zgjedhësve në njësitë zgjedhore. Shpërndarja e mandateve bëhet sipas **metodës së D'Hondt**-it, ku rezultatet përcaktohen për secilën njësi zgjedhore veç e veç, sipas numrit të votave të përgjithshme që i kanë fituar listat e kandidatëve. Secila nga partitë fiton vende të deputetëve proporcionalisht me numrin e votave që i kanë fituar për listën e tyre të kandidatëve, në krahasim me numrin e votave të listave të tjera të kandidatëve. Nëse gjatë ndarjes së vendit të fundit për deputet paraqiten dy lista me rezultate identike, atëherë vendi u ndahet me short. Gjatë shpërndarjes së vendeve të deputetëve, konsiderohen për të zgjedhur aq kandidatë sa vende ka fituar lista. Së këndejmi, mandate fitojnë kandidatët në bazë të radhitjes sipas së cilës janë përcaktuar në listat e kandidatëve. Votimi jashtë vendit mund të bëhet vetëm nëse numri i votuesve të regjistruar korrespondon me numrin më të vogël të votave me të cilat një deputet fitoi një mandat në zgjedhjet e mëparshme parlamentare. Meqenëse numri i aplikimeve të vlefshme të paraqitura është 6096 dhe është më pak se minimumi ligjor, votimi në misionet diplomatike dhe konsullore dhe zyrat konsullore të shtetit jashtë vendit nuk u zhvillua në zgjedhjet parlamentare të vitit 2020, të fundit në kohën e shkrimit të këtyre rreshtave (shtator 2022). Në këtë mënyrë, votuesit që ishin regjistruar të votojnë jashtë vendit dhe plotësonin kërkesat ligjore, kanë mundur ta ushtrojnë të drejtën e tyre të votës në vendvotimet në MV, sipas adresës së tyre të vendbanimit.[113]

Zgjedhjet për deputetë mbahen çdo vit të katërt në 90 ditët e fundit të mandatit të përbërjes së mëparshme parlamentare, ose brenda 60 ditëve nga dita e shpërbërjes së Kuvendit. Në zgjedhjet e parakohshme, të gjitha afatet për aktivitetet zgjedhore shkurtohen për pesë ditë, përveç afatit të përcaktuar për zhvillimin e fushatës zgjedhore.

Një deputeti mund t'i pushojë mandati para skadimit të kohës për të cilën është zgjedhur, nëse paraqet dorëheqje, nëse është dënuar për vepër penale për të cilën është caktuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej më së paku pesë vitesh, nëse paraqitet rast që nuk është në pajtim me funksionin deputet, në rast të vdekjes dhe nëse me vendim të plotfuqishëm i hiqet aftësia e veprimit.

---

[112] **Kodi Zgjedhor** (draft tekst i konsoliduar), version jozyrtar i përgatitur nga Zyra e Ekspertëve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, (*Gazeta Zyrtare*, nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16 136/16, 142/16, 67/17, 125/17, 35/18, 99/18, 140/18, 208/18, 27/19, 98/19 и 42/20). Në internet: https://drive.google.com/ file/d/1FtLITHFCCRi3w c _ 80 nd LxlT 4 FhTgLbSR /view/ (shikuar më 4 tetor 2022).

[113] Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ), Vendim për moszbatimin e votimit në PDK - 2020. Në internet: https://drive.google.com/file/d/1 YL_Qqv Q03 bXPdyJ9BF9I1BtKë_2cN5Ac/view (shikuar më 4 tetor 2022).

Nëse deputeti paraqet dorëheqje, Kuvendi në seancën e parë të radhës konstaton se deputetit i pushon mandati nga dita e mbajtjes së seancës. Nëse deputetit të zgjedhur nga lista e kandidatëve i pushon mandati, sipas njërës nga këto baza, atëherë për pjesën tjetër të mandatit, në vend të tij vjen kandidati i radhës nga lista zgjedhore e partisë në të cilën është zgjedhur deputeti. Përjashtim nga ky rregull bëhet nëse mandati i pushon deputetes. Në rast të këtillë, në vendin e saj, do të vijë kandidatja e radhës nga lista.

Përbërja e re e deputetëve në Kuvend konstituohet në seancën e parë e cila mbahet më së voni 20 ditë pas ditës së zgjedhjeve, ndërsa të njëjtën e thërret kryetari në largim.

Nëse Kuvendi nuk konstituohet në këto 20 ditë, atëherë deputetët mblidhen vet dhe e konstituojnë Kuvendin në ditën e njëzetenjë nga dita e përfundimit të zgjedhjeve në ora 10, ndërsa seancën duhet ta thërras deputeti i zgjedhur më në moshë sipas viteve. Nëse ai refuzon ta thërras, kjo e drejtë i bartet sipas radhës deputetit të zgjedhur të ardhshëm sipas viteve të tij të moshës, kështu deri te deputeti i zgjedhur i cili do të pajtohet ta thërras seancën e parë në të cilën do të konstituohet Kuvendi.

Në një afat prej dhjetë ditësh pas konstituimit të përbërjes së re të Kuvendit, Presidenti i Republikës së MV e ka për detyrë t'ia besojë mandatin për formimin e qeverisë së re kandidatit (mandatar) nga partia ose partitë të cilat kanë shumicë të deputetëve. Mandatari, në afat prej 20-ditësh nga dita e besimit të mandatit, Kuvendit i paraqet program dhe e propozon përbërjen e Qeverisë. Pastaj deputetët me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm të deputetëve e zgjedhin Qeverinë.

11.3. Organet zgjedhore

KSHZ-ja bashkë me komisionet komunale zgjedhore (KKZ), këshillat zgjedhorë (KZ) dhe Komisioni zgjedhor i qytetit të Shkupit, këshillat zgjedhorë (KZ) dhe Këshillat e posaçëm zgjedhorë (KPZ) për votim brenda vendit dhe në përfaqësitë konsullore-diplomatike të Republikës së MV janë organet zgjedhore të ngarkuara për zbatimin e zgjedhjeve parlamentare.

KSHZ-ja përbëhet nga shtatë anëtarë të cilët i zgjedh Kuvendi me dy të tretën e shumicës së votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Mandati i anëtarëve zgjat nga dita e zgjedhjes së Kuvendit deri në zgjedhjen e një përbërje të re të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, por jo më shumë se dy vjet. Parlamenti shpall zgjedhjen e anëtarëve të **KSHZ-së** në Gazetën Zyrtare dhe në shtypin e përditshëm. Njoftimi zgjat tetë ditë nga data e publikimit. Komisioni për Zgjedhjet dhe Emërimet Parlamentare përgatit një listë të kandidatëve të regjistruar dhe ia paraqet atë Parlamentit. Nga kandidatët në listën e propozimeve partitë politike të opozitës emërojnë një president dhe dy anëtarë të **KSHZ-së**, ndërsa partitë në pushtet emërojnë një nënkryetar dhe tre anëtarë të **KSHZ-së**. Nëse partitë politike nuk paraqesin propozime brenda tre ditëve nga marrja e njoftimit, Presidenti, Zëvendëspresidenti dhe anëtarët e **KSHZ-së** propozojnë Komisionin për Çështjet e zgjedhjeve dhe emërimeve të Kuvendit. Kompetencat e KSHZ-së përfshijnë botimin e Listës së Votuesve, e cila duhet të vihet publikisht në dispozicion të qytetarëve brenda 15 ditëve nga data e zgjedhjeve. Inspektimi publik i Listës së Votuesve zgjat 20 ditë. KSHZ-ja ka një shërbim ekspertësh të drejtuar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe kryen detyrat administrative profesionale dhe organizative-teknike.

KKZ-të, të cilat formohen në nivel të çdo komune, dhe Komisioni zgjedhor i qytetit të Shkupit ngarkohen për zbatimin e zgjedhjeve në territorin që është në kompetencë të tyre dhe kryejnë mbikëqyrje mbi punën e këshillave zgjedhorë. Ato përbëhen nga pesë anëtarë, prej të cilëve njëri është kryetar, ndërsa secili nga anëtarët ka zëvendës. Anëtarët dhe zëvendësit e **KKZ-ve** zgjidhen nga radhët e të punësuarve në administratën shtetërore, publike dhe komunale dhe administrata e qytetit të Shkupit me arsim të lartë për mandat prej pesë vitesh. Zgjedhjen e tyre e bën **KSHZ-ja** sipas zgjedhjes së rastësishme pas pranimit të evidencës me të dhënat për administratën shtetërore dhe komunale, administratën e Qytetit të **Shkupit** dhe administratës publike.

KZ është trup i cili formohet për secilin vend zgjedhor, të cilin e përbëjnë pesë anëtarë prej të cilëve njëri është kryetar, ndërsa për secilin prej tyre zgjidhet edhe zëvendës. Kryetari i **KZ** dhe zëvendësi i tij, dy anëtarë dhe zëvendësit e tyre zgjidhen nga radhët e të punësuarve në administratën shtetërore, publike dhe komunale dhe administrata e qytetit të Shkupit, më së paku shkollë të mesme të përfunduar sipas zgjedhjes së rastësishme për periudhë kohore prej katër vitesh. Një anëtar të KZ dhe zëvendësi i tij emërohen me propozim të partive politike në opozitë, të cilat në zgjedhjet e fundit për deputetë kanë fituar më së shumti vota, ndërsa një anëtar tjetër me propozim të partive politike në pushtet të cilat në zgjedhjet e fundit për deputetë kanë fituar më së shumti vota. Zgjedhjen e rastësishme e anëtareve të këshillave zgjedhorë (nga radhët e administratës) e bëjnë **KKZ-të** për zonën për të cilën janë kompetentë, sipas aktit paraprak të **KSHZ-së**.

KPZ-të qenë formuar për të kryer votimin e votuesve që kanë qenë në karantinën e brendshme për shkak të një testi pozitiv të COVID-19 dhe personave të cilëve iu qe caktuar masa për izolim. Anëtarët e këtyre bordeve qenë emëruar nga Ministria e Shëndetësisë dhe partitë politike nga qeveria dhe opozita, e cila fitoi më shumë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare, me kërkesë të **KSHZ-së**.

Në ato komuna ku jetojnë të paktën 20% e komuniteteve joshumicë, zbatohet parimi i përfaqësimit të drejtë në përbërjen e **KKZ**-ve dhe këshillave zgjedhore. Ligji gjithashtu parashikon të paktën 30% përfaqësim të secilës gjini në përbërjen e organeve zgjedhore.

Anëtarët e **KKZ**-ve dhe këshillave zgjedhore nuk mund të zgjidhen ose emërohen nga zyrtarë të qeverisë, parlamentit dhe persona të punësuar në administratën shtetërore të Avokatit të Popullit, Ministritë e Drejtësisë, Mbrojtjes, Punëve të Brendshme, Sekretariatin e Legjislacionit, Zyrën Shtetërore të Statistikave, Drejtorinë e mbrojtjes dhe shpëtimit, Qendrën e menaxhimit të krizave, Shërbimet profesionale të Gjykatës Administrative, KSHZ, Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit (SCPC) dhe Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

11.4. E drejta e zgjedhjes aktive dhe pasive, procedura e paraqitjes së kandidaturave

Të drejtë vote ka shtetasi i Republikës së MV i cili ka mbushur 18 vjet, ka zotësi veprimi dhe ka vendbanim të përhershëm në njësinë zgjedhore, komunën ose qytetin e Shkupit ku bëhet zgjedhja. Votimi është i fshehtë dhe askush nuk ka të drejtë ta thërras zgjedhësin në përgjegjësi për shkak të votimit dhe të mos kërkojë nga ai të tregoj për kë ka votuar ose pse nuk ka votuar. **KSHZ-ja** është përgjegjëse t'i informojë dhe edukojë qytetarët për mënyrën e votimit dhe për realizimin e të drejtës së zgjedhjes, së këndejmi në vendvotimet dhe në paravanët e votimit afishohet udhëzimi për votim në gjuhën maqedonase, shqipe, turke, vllahe, serbe, rome dhe në gjuhën boshnjake. Listat e kandidatëve, gjithashtu, afishohen në hapësirën e votimit.

Të drejtën e kandidimit për deputet e ka secili qytetar i moshës madhore, nëse nuk është dënuar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor, me dënim me burgim të pakushtëzuar mbi gjashtë muaj, vuajtja e të cilit akoma nuk ka filluar ose është në vuajtje të dënimit me burgim për vepër të kryer penale. Gjithashtu, nëse ndonjë qytetari me vendim të formës së prerë i është përcaktuar bashkëpunimi me organet e sigurisë shtetërore, e drejta e ushtrimit të funksionit publik i kufizohet për një afat prej pesë vitesh nga dita e vendimit përfundimtar.

Të drejtën për votim dhe kandidaturë për deputet kanë edhe qytetarët maqedonas të cilët kanë regjistruar vendbanimin e tyre të fundit në vend dhe që kanë qenë përkohësisht banues jashtë vendit për më shumë se tre muaj ose kanë qenë të punësuar përkohësisht ose qëndrojnë jashtë për më shumë se një vit nga dita e zgjedhjeve, sipas të dhënave nga autoritetet zyrtare. Për të ushtruar të drejtën e tyre për të votuar, këta qytetarë duhet të paraqesin një kërkesë (të nënshkruar ose të dërguar përmes aplikacionit me postë elektronike personale) në misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së MV, me të cilën aplikojnë për të votuar në zgjedhjet e ardhshme dhe regjistrohen në fragmente të veçanta nga lista e zgjedhësve. Këta qytetarë

votojnë në misionet diplomatike dhe konsullore, një ditë para zgjedhjeve në vend. Nëse shtetasit që janë duke punuar përkohësisht ose qëndrojnë jashtë vendit nuk paraqesin kërkesën e tyre për votim brenda afatit të caktuar, ata do të regjistrohen në fragmentet e Listës së Votuesve sipas vendbanimit të tyre të fundit të paraqitur në vend.

Propozimi i kandidatëve për zgjedhje të deputetëve bëhet përmes paraqitjes së listës së kandidatëve në **KSHZ**. Së këndejmi, një kandidat mund të propozohet vetëm në një listë, ndërsa një paraqitës liste mund të paraqes vetëm një listë të kandidatëve për deputetë. Në listat e kandidatëve për deputetë, duhet më së paku 40% të kandidatëve t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar, me ç'rast për çdo tre vende një vend i takon gjinisë më pak të përfaqësuar dhe në mënyrë plotësuese edhe më së paku nga një vend për çdo 10 vende. Listat paraqiten në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik si gjuhë zyrtare oficiale në Republikën e MV, megjithatë paraqitësi i listave në njësitë zgjedhore në të cilat më së paku 20 % e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, këtë mund ta bëjë edhe në gjuhën dhe alfabetin që e përdorin qytetarët në atë njësi të vetëqeverisjes lokale.

Të drejtë që të paraqesin listë të kandidatëve për deputetë kanë partitë e regjistruara politike në mënyrë të pavarur, koalicionet, si dhe grupi i zgjedhësve. Grupi i zgjedhësve në mënyrë që të mund të paraqes listë të kandidatëve nevojitet të grumbullojë më së paku 1.000 nënshkrime nga zgjedhësit e regjistruar në ekstraktin e Listës së Zgjedhësve të njësisë zgjedhore. Mbledhja e nënshkrimeve bëhet para zyrtarëve të **KSHZ-së** dhe një noteri publik kompetent në një formë të përcaktuar nga **KSHZ-ja**. Dorëzuesi i listës përcakton përpara së cilit noterët nënshkrimet do të mblidhen dhe informon Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve. **KSHZ-ja** publikon në faqen e tij të internetit një listë të noterëve para se paraqitësit e listave të mbledhin nënshkrime. Një zgjedhës mund ta jap nënshkrimin e vet për më shumë lista të kandidatëve për deputetë. Në zgjedhje të rregullta grumbullimi i nënshkrimeve fillon në ditën e dhjetë nga dita e shpalljes së zgjedhjeve dhe zgjatë 15 ditë.

Në rastin kur paraqitës i listës së kandidatëve është parti politike, doemos duhet të paraqes vërtetim për regjistrim nga gjykata kompetente. Kur paraqitësi i listës së kandidatëve është koalicioni, duhet ta paraqes marrëveshjen e koalicionit ndërmjet partive. Kur paraqitës i listës është grup zgjedhësish, doemos duhet të dorëzohet numri i nevojshëm i nënshkrimeve nga votuesit. Për çdo kandidaturë nevojitet pëlqim me shkrim (deklaratë) e kandidatit që është i parevokueshëm. Listat e kandidatëve paraqiten në komisionin zgjedhor kompetent, më së voni 35 ditë, para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

KSHZ-ja, përkatësisht KKZ-të, pastaj konstatojnë nëse listat janë paraqitur në afatin ligjor dhe sipas kushteve të parashikuara me ligj. Nëse konstatohen parregullsi, KSHZ-ja, përkatësisht KKZ-ja do ta thërras përfaqësuesin e autorizuar të paraqitësit të listës, përkatësisht personin e parë të nënshkruar në listën e kandidatëve, që t'i shmangin parregullsitë në afat prej 48 orësh nga pranimi dhe nga raportimi i komisionit për parregullsitë. Nëse pastaj konstatohet se listat janë paraqitur në përputhje me dispozitat ligjore dhe se parregullsitë e konstatuara eventuale janë shmangur brenda afatit të caktuar, atëherë lista e paraqitur verifikohet me aktvendim. Nëse konstatohet se listat nuk janë paraqitur në kohë, përkatësisht parregullsitë ose mangësitë e konstatuara, paraqitësit e listave nuk i kanë shmangur në afat prej 48 orësh, atëherë do të miratohet aktvendim për hedhjen poshtë të listës. Paraqitësi i listës, kundër aktvendimit mund të paraqes padi në Gjykatën Administrative, në afat prej 24 orësh pas pranimit të aktvendimit, ndërkaq Gjykata, në afat prej 24 orësh, pas pranimit të padisë duhet të vendos për të njëjtën.

Listat e verifikuara të kandidatëve për deputetë në njësitë zgjedhore, KSHZ-ja i shpall në shtypin ditor prej të cilëve njëri është në gjuhën e bashkësisë të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve në Republikën e MV, më së voni 23 ditë para ditës së përcaktuar për mbajtjen e zgjedhjeve.

11.5. Vëzhgimi zgjedhjeve

Vëzhguesit e akreditуar kanë të drejtë të vëzhgojnë zgjedhjet, me autorizimin që lëshohet nga KSHZ-ja. Vëzhguesit mund të akreditohen nga OShC-të vendase dhe të huaja të regjistruara të paktën një vit para zgjedhjeve dhe të përfshijnë parimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në statutin e tyre. Përfaqësuesit e vendeve të huaja gjithashtu mund të vëzhgojnë zgjedhjet. Përfaqësuesit e autorizuar të paraqitësve të listës kanë të drejtë të emërojnë përfaqësuesin e tyre i cili do të monitorojë punën e organeve zgjedhore.

11.6. Zgjedhjet lokale dhe organet për zhvillimin e tyre

Sistemi zgjedhor për kryetarët e komunave është mazhoritar me dy rrethe. Zgjedhjet përsëriten në rrethin e dytë për ata dy kandidatë të cilët kanë fituar numër më të madh të votave. Nëse në zgjedhje merr pjesë vetëm një kandidat, ndërkaq i njëjti nuk e fiton shumicën e nevojshme, procedura zgjedhore përsëritet. Rrethi i dytë i votimit zbatohet 14 ditë pas përfundimit të rrethit të parë. Në rrethin e dytë zgjidhet ai kandidat i cili ka fituar numër më të madh të votave.

Gjatë zgjedhjes së këshilltarëve në njësitë e vetëqeverisjes lokale (NJVL) zbatohet modeli proporcional, ku shpërndarja e mandateve bëhet sipas **metodës së D'Hondt**-it. Sipas kësaj formule, numri i përgjithshëm i votave të fituara për listat e propozuara të kandidatëve pjesëtohet me vargun e përpjesëtuesve 1,2,3... kështu deri në numrin e anëtarëve të këshillit të cilët zgjidhen në NJVL konkrete. Herësit (koeficientët) e fituar në këtë mënyrë radhiten sipas madhësisë, ku merren parasysh ata herës më të mëdhenj aq sa zgjidhen anëtarë të këshillit. Një listë e kandidatëve i fton aq anëtarë të këshillit sa ka herës (koeficientë) më të mëdhenj prej atyre që janë marrë parasysh.

Organe të cilat i zbatojnë zgjedhjet janë: **KSHZ-ja**, komisionet komunale të zgjedhjeve (KKZ) dhe Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit, këshillat zgjedhorë (KZ) dhe Këshillat e posaçëm zgjedhorë (KPZ) për votim brenda vendit.

KSHZ-ja është organ i njëjtë si te rasti zgjedhjeve parlamentare, përkatësisht për çdo zgjedhje apo referendum në MV: përbëhet nga shtatë anëtarë të cilët i zgjedh Kuvendi me dy të tretën e shumicës së votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Mandati i anëtarëve zgjat nga dita e zgjedhjes së Kuvendit deri në zgjedhjen e një përbërje të re të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, por jo më shumë se dy vjet. Parlamenti shpall zgjedhjen e anëtarëve të **KSHZ**-së në Gazetën Zyrtare dhe në shtypin e përditshëm. Njoftimi zgjat tetë ditë nga data e publikimit. Komisioni për Zgjedhjet dhe Emërimet Parlamentare përgatit një listë të kandidatëve të regjistruar dhe ia paraqet atë Parlamentit. Nga kandidatët në listën e propozimeve partitë politike të opozitës emërojnë një president dhe dy anëtarë të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndërsa partitë në pushtet emërojnë një nënkryetar dhe tre anëtarë të **KSHZ-së**. Nëse partitë politike nuk paraqesin propozime brenda tre ditëve nga marrja e njoftimit, Presidenti, Zëvendëspresidenti dhe anëtarët e **KSHZ-së** propozojnë Komisionin për Çështjet e zgjedhjeve dhe emërimeve të Kuvendit. Kompetencat e **KSHZ**-së përfshijnë botimin e Listës së Votuesve, e cila duhet të vihet publikisht në dispozicion të qytetarëve brenda 15 ditëve nga data e zgjedhjeve. Inspektimi publik i Listës së Votuesve zgjat 20 ditë. KSHZ-ja ka një shërbim ekspertësh të drejtuar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe kryen detyrat administrative-profesionale dhe organizative-teknike.

KKZ-të, të cilat formohen në nivel të çdo komune, dhe Komisioni zgjedhor i qytetit të Shkupit ngarkohen për zbatimin e zgjedhjeve në territorin që është në kompetencë të tyre dhe kryejnë mbikëqyrje mbi punën e këshillave zgjedhorë. Ato përbëhen nga pesë anëtarë, prej të cilëve njëri është kryetar, ndërsa secili nga anëtarët ka zëvendës. Anëtarët dhe zëvendësit e **KKZ-ve** zgjidhen nga radhët e të punësuarve në administratën shtetërore, publike dhe komunale dhe administrata e qytetit të Shkupit me arsim të lartë për mandate prej pesë vitesh. Zgjedhjen e tyre e bën KSHZ-ja sipas zgjedhjes së

rastësishme pas pranimit të evidencës me të dhënat për administratën shtetërore dhe komunale, administratën e Qytetit të Shkupit dhe administratës publike.

KZ është trup i cili formohet për secilin vend zgjedhor, të cilin e përbëjnë pesë anëtarë prej të cilëve njëri është kryetar, ndërsa për secilin prej tyre mbi 6 muajsh, vuajtja e të cilit nuk ka filluar, ose gjendet në vuajtje të dënimit për vepër të kryer penale, nuk mund të jetë kandidat për këto pozita. Përveç këtyre kushteve, kandidati për kryetar komune ose për anëtar të këshillit duhet të ketë vendbanim të përhershëm në NJVL në të cilën kandidohet.

11.7. Zgjedhjet presidenciale

Institucioni i presidencës filloi pas shpalljes së pavarësisë më 8 shtator 1991. Presidenti i parë ishte **Kiro Gligorov** (1917-2012), presidenti më i vjetër në botë deri në dorëheqjen e tij në vitin 1999. Presidenca është kryesisht një post ceremonial dhe kryeministri i MV është figura kryesore politike e vendit dhe shefi ekzekutiv.

Presidenti duhet të jetë shtetas i MV, të jetë mbi 40 vjeç. Për President të Republikës së MV nuk mund të zgjidhet personi i cili deri në ditën e zgjedhjeve nuk ka qenë banor i Republikës së MV së paku dhjetë vjet në 15 vitet e fundit.[114] Presidenti i MV zgjidhet duke përdorur një sistem të modifikuar dy raundesh. Një kandidat mund të zgjidhet vetëm në raundin e parë të votimit nëse ata marrin ekuivalentin e mbi 50% të votave nga të gjithë votuesit e regjistruar. Në raundin e dytë, pjesëmarrja e votuesve duhet të jetë së paku 40% që rezultati të konsiderohet i vlefshëm. Këto ndryshime janë bërë në vitin 2009.[115] Deri atëherë, sipas paragrafit 5 të nenit 81 të KMVe, për president është zgjedhur kandidati i cili ka fituar shumicën e votave të zgjedhësve të cilët kanë votuar, në qoftë se kanë votuar më shumë se gjysma e zgjedhësve. Sikundër shihet, pra, për president të MV përdoret sistemi mazhoritar me dy raunde. Kandidat për President të Republikës mund të propozojnë së paku 10.000 zgjedhës ose së paku 30 deputetë.[116]

12. Zgjedhjet në Mal të Zi

12.1. Kuadri kushtetues e ligjor i sistemit zgjedhor në Mal të Zi

Sistemi shumëpartiak në Mal të Zi u fut pas rrënimit të komunizimit, me nxjerrjen e Ligjit për zgjedhjen dhe revokimin e këshilltarëve dhe deputetëve dhe Ligjit mbi zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të **Kryesisë së Republikës Socialiste të Malit të Zi** me 28 shtator dhe 3 tetor 1990 respektivisht.[117] Në të njëjtën kohë me këtë, Kuvendi Malit të Zi ka nxjerr vendimin mbi emërimin e anëtarëve të Komisionit zgjedhor republikan, në përbërjen e të cilin kanë hyrë përfaqësuesit e shumë partive politike dhe shoqatave. Pluralizmi politik në Mal të Zi definitivisht do të futet më 9 dhjetor 1990, kur u mbajtën zgjedhjet e para pluraliste, ku u regjistruan 18 organizata politike. Me miratimin e Kushtetutës së Malit të Zi të vitit 1992 (KMZi 92) u krijua një bazë stabile për pluralizëm politik, por edhe për mbrojte të të drejtave dhe lirive themelore të pakicave në këtë vend.

---

114 Neni 80 i **KMVe.**

115 KMVe, amendamenti XXXI.

116 Neni 81.1 i **KMVe.**

117 *Sluzbeni List Crne Gore* br. 36/90 (Podgorica). Pas rënies së komunizmit, të gjitha republikat ish-jugosllave kanë miratuar ligjet zgjedhore, me të cilat është futur sistemi shumëpartiak dhe pluralizmi politik, dhe atë sipas kësaj renditje kohore: **Sllovenia** më 27 shtator 1989 ka nxjerrë Ligjin mbi zgjedhjet shumëpartiake; **Kroacia** më 15 shkurt 1990 ka nxjerr Ligjin mbi zgjedhjen dhe revokimin e këshilltarëve dhe deputetëve; **Bosnje-Hercegovina** me 31 qershor 1990 ka nxjerr Ligjin për zgjedhjet; **MV** më 21 shtator 1990 ka nxjerr Ligjin zgjedhor; dhe, së fundi, **Serbia** më 28 shtator 1990 ka bërë të njëjtën gjë. Cf. më shumë për këtë në Dragan Đukanović, "Izborni sistemi u zemljama nekadašnje Jugoslavije". *Međunarodni problemi* Vol. LVIII, br. 4 (Decembar 2006) fq. 513-536.

Në Mal të Zi, përveç **Kushtetutës së Malit të Zi** të vitit 2007, aktualisht në fuqi me amendamentet e vitit 2007 (KMZi), për të drejtën zgjedhore kanë relevancë edhe akte të tjera juridike, mes tjerash për sa vijon:

- Ligji për partitë politike i vitit 2004, me ndryshimet e fundit të vitit 2011;
- Ligji mbi regjistrat e vendbanimit dhe vendqëndrimit i vitit 2015;
- Ligji mbi regjistrat e zgjedhësve (2006);
- Ligji mbi referendumin i 19 shkurtit 2001;
- Ligji mbi zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve (me amendamentet e fundit të vitit 2016);
- Ligji mbi vetëqeverisjen lokale i vitit 2018 (me amendamentet e fundit të vitit 2020);
- Ligji mbi financimin e partive politike i vitit 2008;
- Ligji mbi financimin e fushatës zgjedhore për president të Republikës së Malit të Zi dhe kryetarin e komunës i vitit 2009;
- Ligji mbi zgjedhjen e Presidentit të Malit të Zi i miratuar më 27 dhjetor 2007 (me ndryshimet e fundit të vitit 2009).

Kjo infrastrukturë juridike, me emrat pak më të ndryshëm, ekziston në të gjitha vendet fqinje me Kosovën dhe, kur bëhet fjalë për vendet përreth që kanë president që zgjidhet me votën e drejtpërdrejtë të qytetarëve (MV, Mali i Zi dhe Serbia), e njëjta vlen edhe për legjislacionin që normon këtë zgjedhje. Krahas këtyre teksteve juridike, për prodhimin e këtij seksioni kemi përdorur librin e doajenit të së drejtës kushtetuese të Malit të Zi, prof. **Mijat Shukoviq**, si dhe materiale e hulumtime të ndryshme të prodhuara nga sektori civil me ekspertizë në sistemet dhe të drejtën zgjedhore malazeze.[118] Në infrastrukturën juridike të së drejtës zgjedhore hyjnë dhe zënë një vend të rëndësishëm edhe aktet e brendshme dhe vendimet e institucioneve që organizojnë, mbikëqyrin dhe realizojnë zgjedhjet, njëjtë si në Kosovë.

Sikundër shihet, në të gjitha vendet përreth Kosovës ekziston sistemit shumëpartiak dhe një sistem zgjedhor pak a shumë i njëjtë kur bëhet fjalë për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare dhe zgjedhjet për këshilltar lokalë. Për pasojë, edhe e drejta zgjedhore në këto vende shpërfaqë ngjashmëri të dukshme.

12.2. Sistemi zgjedhor

Edhe ligjvënësi malazez, njëjtë si vendet tjera përreth Kosovës, ka përzgjedhur sistemin proporcional zgjedhor. Për dallim nga vendet përreth dhe përkundër modifikimeve që ka pësuar, sistemi zgjedhor malazez ka kultivuar sistemin proporcional të listave partiake. Pas futjes së sistemit shumëpartiak në

[118] OSCE/ODIHR, *Assessment of the Referendum Law. Republic of Montenegro. Federal Republic of Yugoslavia* (Warsaw 6 July 2001); Vladimir Goati, *Izbori u SRJ od 1990 do 1998. Volja gradjana ili manipulacija.* II DOPUNJENO IZDANJE (CENTAR ZA SLOBODNE IZBORE I DEMOKRATIJU: Beograd, 2001); CeSID, *Oko izbora. Izvestaj sa lokalnih izbora za odbornike 19 skupstina opstina Crne Gore* (15. maja 2002. godine) (CENTAR ZA SLOBODNE IZBORE I DEMOKRATIJU: Podgorica, 2002); Veselin Pavićević, Olivera Komar, Zlatko Vujović (eds.), ***Izbori i izborno zakonodavstvo u Crnoj Gori 1990 – 2004*** **(**CEMI: Podgorica, 2005); Centar za monitoring CEMI*, Referendum u Crnoj Gori 2006. godine* (Podgorica, 2006); Veselin Pavićević, Srđan Darmanović, Olivera Komar, Zlatko Vujović (eds.), *Izbori i izborno zakonodavstvo u Crnoj Gori 1990 – 2006* (CEMI: Podgorica, 2007); CEMI, *IZBORNI I PARTIJSKI SISTEM U CRNOJ GORI. PERSPEKTIVA RAZVOJA UNUTARPARTIJSKE DEMOKRATIJE* (Centar za monitoring i istraživanje CeMI: Podgorica, 2007); Mijat Šuković, *Ustavno pravo*; Vladimir Goati, Srđan Darmanović (eds.), *IZBORNI I PARTIJSKI SISTEM U CRNOJ GORI. PERSPEKTIVA RAZVOJA UNUTARPARTIJSKE DEMOKRATIJE* (CEMI, Podgorica, 2014); CEMI, *Reforma izbornog zakonodavstva u Crnoj Gori. Prijedlozi za unapređenje* (Centar za monitoring i istraživanje CeMI: Podgorica, 2015); OSCE/ODIHR, *Crna Gora. PARLAMENTARNI IZBORI: 30. AVGUST 2020. Ograničena posmatračka misija Kancelarije za demokratske institucije i ljudska prava (KDILJP). Konačni izvještaj* (Varšava, 11. decembar 2020); mr Zlatko Vujović, mr Nikoleta Tomović, *Održivi institucionalni mehanizmi za poboljšanje predstavljenosti manjina u crnogorskom Parlamentu* (European Fund for the Balkans: Podgorica, 2020); Zlatko Vujović (ed.), *GRAĐANSKO NADGLEDANJE PARLAMENTARNIH I LOKALNIH IZBORA CRNA GORA 2020. FINALNI IZVJEŠTAJ* (CEMI: Podgorica, 2020); Đorđije Blažić, *Zarobljeni izborni sistem* (FDES: Podgorica, 2021).

vitin 1989, deri në shkrimin e këtyre rreshtave (tetor 2022), në **Mal të Zi** janë mbajtur zgjedhjet parlamentare tetë herë (1990, 1992, 1996, 1998, 2001, 2006, 2009, 2012, 2016 dhe 2020). Përkundër që ka qenë në përdorim sistemi i listave partiake, ndryshimet e bëra në të kryesisht kanë pasur për qëllim favorizimin e koalicionit dominant. Disa ndryshime në këtë sistem mund të identifikohen si kalim nga sistemi kryesisht proporcional (1990), përmes aplikimit të kombinuar të sistemit mazhoritar e proporcional (1992), më pas të sistemit të pastër proporcional (1992), në drejtim të një sistemi të përzier (1996), përkatësisht përmbledhjes së elementeve pozitive të sistemit mazhoritar dhe efekteve negative të modelit proporcional dhe, në fund, në kalim përfundimtar të institutit të diskriminimit pozitiv për njërin prej pakicave kombëtare në këtë vend – shqiptarëve (1996, 1998 dhe 2002).[119]

Për t'i kuptuar efektet kryesore të cilat i ka prodhuar në **Mal të Zi**, në përdorim tri variabla të pavarura për diskutim dhe analizë:

- **metoda e shpërndarjes së mandateve**;
- **numri dhe madhësia e njësive zgjedhore**; dhe
- **mënyra e votimit – lloji listës zgjedhore**.

Kjo qasje kësisoj e bën më të krahasueshëm dhe më të kuptueshëm sistemin malazez të zgjedhjeve me sistemet tjera përreth.

12.3. Metoda e shpërndarjes së mandateve

Nga futja e sistemit shumëpartiak dhe parlamentarizmit, Mali i Zi ka përdorur sistemin proporcional të listave partiake. Në përdorim sot janë listat e mbyllura dhe të bllokuara partiake (të kandidatëve), pa mundësi të votimit preferencial. Kjo do të thotë se votuesit nuk dinë për kënd votojnë efektivisht. **Mali i Zi** përfaqëson një njësi zgjedhore, madhësia e së cilës është e barabartë me madhësinë e parlamentit të Malit ët Zi, pra 81 deputet.

Të drejtën për paraqitje të listave të kandidatëve e kanë partitë e regjistruara, koalicionet ose grupet e qytetarëve. Në listën zgjedhore duhet të jenë së paku 54 (⅔ e numrit të deputetëve), e më së shumti 81 kandidatë (numër i njëjtë me deputetët në **Kuvendin e Malit të Zi**). Këtu bëjnë përjashtim listat e grupit të qytetarëve apo partitë politike që përfaqësojnë popullin pakicë apo bashkësinë nacionale pakicë, të cilët kanë detyrim për të nominuar së paku 1/3 (27 kandidatë) nga numri i përgjithshëm i deputetëve në Kuvendin e Malit të Zi, pra numri 81.

Sipas Ligjit mbi zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve, secila listë zgjedhore duhet të ketë 30 % kandidatë nga gjinia më pak e përfaqësuar, ashtu që çdo i katërti i kandidatëve në listë të jetë nga kjo gjini.

Për alokimin e mandateve listave të kandidatëve të kualifikuar për një gjë të tillë përdoret **metoda d'Hondt**, krahas përdorimit të pragut zgjedhor të përcaktuar me ligj. Në procesin e shpërndarjes së mandateve sipas kësaj metode hyjnë vetëm ato lista që kalojnë pragun zgjedhor. Kjo do të thotë se, aktualisht, lista zgjedhore duhet të fitoj më së paku 3 % të votave të vlefshme, në mënyrë që të merr pjesë në shpërndarjen e mandateve. Pragu zgjedhor ligjor, në rastin e partive të pakicave, ekziston si kusht për shpërndarje të mandatit në rastin pakicës kroate. Përkundër rekomandimeve të **Komisionit të Venecias**, **Organizatës për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë** (OSBE/ODIHR) në **Mal të Zi**, kandidatët e pavarur nuk kanë mundësi të marrin pjesë në zgjedhje. Kandidatët e pavarur mund të marrin pjesë vetëm në kuadër të listës së kandidatëve.

[119] Veselin Pavićević, Olivera Komar, Zlatko Vujović (eds.), ***Izbori i izborno zakonodavstvo u Crnoj Gori 1990 – 2004***, fq. 59.

Në rastin e sistemit të listave partiake të kandidatëve, që përdoret në Mal të Zi, roli i pragut zgjedhor është në pamundësimin e partive të vogla për të fituar vend në parlament dhe për të rrezikuar stabilitetin e sistemit politik, duke pamundësuar formimin e qeverisë. Sa i përket pakicave dhe diskriminimit pozitiv, pragu zgjedhor shërben si një mandat i rezervuar. Kjo në veçanti vlen për **pakicën kombëtare shqiptare** e cila, formalisht, që nga vitit 1998 ka fituar një status pak më të privilegjuar se pakicat tjera në Mal të Zi.

Pas krizës së thellë politike në shtet, gjatë vitit 1997, njëri ndër kushtet themelore për mbajtjen e zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare në vitin 1998 ka qenë miratimi i Ligjit të ri për zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve. Ligji zgjedhor u miratua në seancën e dytë të jashtëzakonshme të **Kuvendit të Malit të Zi**, më 18 shkurt 1998. Neni 12 i Ligjit ka precizuar se zgjedhja e deputetëve bëhet në njësinë e vetme zgjedhore - në Republikën e Malit të Zi: Sërish u rikthye sistemi zgjedhor i vitit 1992, por u ruajt zgjidhja sipas së cilës një deputet zgjidhet nga 6000 votues. Kuvendi i Republikës, ndërkaq, fitoi autorizim ligjor për të përcaktuar me vendim të posaçëm numrin e deputetëve. Këtë ajo duhej ta bënte më së largu deri në ditën e shpalljes së zgjedhjeve. Në dispozitat kalimtare dhe të fundit, Ligji përcaktonte që, krahas asaj që **Mali i Zi** përfaqësonte një njësi zgjedhore, pesë nga numri tërësishëm i deputetëve do të votoheshin në vendvotimet e përcaktuara me vendim të veçantë të Kuvendit të **Malit të Zi**. Kjo është bërë me qëllim të krijimit të hapësirës për përfshirje sa më të madhe të përfaqësuesve të pakicës shqiptare në **Kuvendin e Malit të Zi.** Rrënjët e mandateve të rezervuara si këto në dobi të pakicës shqiptare datojnë që zgjedhjet paraprake të vitit 1996, kur u patën themeluar dy njësi zgjedhore që nuk kanë ndjekur (nuk janë përputhur më) kufijtë administrativë të komunave. Ato ishin njësi zgjedhore ku shqiptarët përbënin shumicën e popullsisë, pa marrë parasysh komunat në të cilat jetonin ata. Në këtë mënyrë katër mandate praktikisht qenë rezervuar për përfaqësuesit e komunitetit shqiptar në njësitë zgjedhore 8 (Podgorica II) dhe 9 (Ulqini).

Pragu zgjedhor ka ndryshuar disa herë mes cikleve zgjedhore. Në tri ciklet e para zgjedhore (1990, 1992 dhe 1996) ka qenë në përdorim pragu zgjedhor prej 4% nga numri i tërësishëm i votuesve që kanë votuar në njësi zgjedhore. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 1998, përkatësisht 2001 u përcaktua pragu prej 3% të votave të tërësishme të votuesve që kanë votuar në njësinë zgjedhore. Sistem i njëjtë është zbatuar edhe në zgjedhjet e vitit 2002 (71 deputetë, plus 4 të tjerë në njësitë e posaçme zgjedhore, pra kanë ekzistuar njësia republikane dhe katër njësi të posaçme zgjedhore). Me ndryshimet në ligjin zgjedhor në vitin 2011, është futur pragu i diferencuar zgjedhor, ashtu që krahas pragut prej 3% ekzistojnë edhe pragu prej 0.7% për partitë e pakicave dhe pragu prej 0.35% për partitë që përfaqësojnë bashkësinë nacionale kroate. Për pragun e përcaktuar me ligj për bashkësitë pakicë mund të thuhet se përfaqëson një lloj të mandatit të rezervuar, sepse kalimi i pragut garanton fitimin e mandatit të parë për secilën prej pakicave, pa marrë parasysh madhësinë e koeficientit sipas **metodës d'Hondt**.

Kur bëhet fjalë për **zgjedhjet lokale**, lista zgjedhore duhet të fitojë më së paku 3% të votave të vlefshme, në mënyrë që të merr pjesë në shpërndarjen e mandateve. Pragu zgjedhor i përcaktuar me ligj është i ndryshëm për pakicat. E drejta për diskriminim pozitiv definohet me Ligjin për zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve, nenin 94 parag. 2 (1). Sipas kësaj dispozite, lista e kandidatëve për pakicat nënkupton ato pakica apo bashkësi që marrin pjesë me 15% nga numri i tërësishëm i njësisë zgjedhore, sipas të dhënave të regjistrimit të fundit të popullsisë. Në nivelin lokal, me rastin e zgjedhjes së këshilltarëve të listës së pakicave, kur asnjëra prej tyre nuk ka kaluar pragun prej 3%, atëherë ato fitojnë të drejtën për pjesëmarrje në ndarjen e mandateve individualisht sipas votave të vlefshme të fituara, që do të thotë se ndaj tyre nuk zbatohet pragu ligjor prej 3% por kualifikohen drejtpërdrejt në procesin e shpërndarjes së mandateve përmes zbatimit të **metodës d'Hondt.**

12.4. Numri dhe madhësia e njësive zgjedhore

Në zgjedhjet e para parlamentare të vitit 1990, pas futjes së parlamentarizimit, **Mali i Zi** ka qenë i ndarë në njësi zgjedhore, kufijtë e të cilave janë puqur me kufijtë e komunave, që do të thotë se çdo komunë ka qenë një njësi zgjedhore. Parim i ngjashëm është ndjekur edhe për zgjedhjet lokale, me një dallim që komunat janë ndarë nëpër njësi zgjedhore me numër thuajse të njëjtë të votuesve. Shpërndarja e numrit të mandateve nëpër komuna është varur nga pjesëmarrja e numrit të votuesve në trupën e tërësishme zgjedhore të Malit të Zi.

Nëse krahasohen të gjitha zgjedhjet parlamentare në **Mali** të Zi, atëherë do të shihet se ligjvënësi malazez më së shumti është orientuar për zgjidhje sipas së cilës **Mali i Zi** paraqet një njësi zgjedhore. Përjashtim nga këto bëjnë dy palë zgjedhje, ato të vitit 1990 dhe 1996. Në zgjedhjet e dyta parlamentare, që kanë qenë njëkohësisht zgjedhjet e para të jashtëzakonshme, **Mali i Zi** është shndërruar në një njësi zgjedhore, për të kaluar në ndryshim radikal në zgjedhjet e radhës kur ky vend u nda në 14 njësi zgjedhore. Në zgjedhjet e dyta të jashtëzakonshme të vitit 1998, ligjvënësi ka kthyer zgjidhjen e vjetër dhe **Mali i Zi** sërish u bë një njësi zgjedhore. Kjo gjendje edhe sot është në fuqi.

12.5. Shpërndarja e mandateve

Alokimi i mandateve të fituara në zgjedhje, përkatësisht kthimi i votës në mandat deputeti sipas metodës së sipërshënuar, kalon nëpër disa faza. Këto jepen në vijim dhe janë shumë të ngjashme me zgjedhjet nacionale në Kosovë dhe në vendet tjera përreth.

Hapi i parë: konstatimi i rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve

Në bazë të materialit të mbledhur nga të gjitha vendvotimet në Mal të Zi, nis konstatimi i rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve nga ana e KQZ-së, në shprehje numerike që përfshinë këto kategori: numrin e votuesve të regjistruar në regjistrin e votuesve; numrin e votuesve që kanë votuar në vendvotime; numrin e votuesve që kanë votuar me shkrim; numrin e përgjithshëm të votuesve; numrin e fletëvotimeve të pranuara; numrin e fletëvotimeve të papërdorura; numrin e fletëvotimeve të përdorura; numrin e fletëvotimeve të pavlefshme dhe numrin e fletëvotimeve të vlefshme.

Hapi i dytë: konstatimi i numrit të tërësishëm të votave të të gjitha listave zgjedhore

Pas prezantimit të të dhënave të përgjithshme mbi rezultatet zgjedhore, në të gjitha vendvotimet e Malit të Zi, kalohet në procedurën e konstatimit të numrit të tërësishëm të votave të listave zgjedhore sipas renditjes në listën e përbashkët zgjedhore.

Hapi i tretë: konstatimi i listave zgjedhore që kanë kaluar pragun

Konform nenit 94 parag. 1 të Ligjit për zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve në shpërndarjen e mandateve marrin pjesë vetëm listat zgjedhore që kanë marrë më shumë se 3% të krejt votave të vlefshme. Kjo bëhet me shikim të thjeshtë në tabelën që përmban numrin e tërësishëm të votave që ka marrë secila listë zgjedhore individualisht.

Hapi i katërt: konstatimi i listave zgjedhore që nuk kanë kaluar pragun zgjedhor

Hapi i radhës është konstatimi i listave zgjedhore që nuk kanë marr numrin e nevojshëm të votave që mundëson marrjen pjesë në shpërndarjen e mandateve, pra nuk kanë kaluar pragun prej 3%. Këtu vetëm jepen emrat e listave që nuk janë kualifikuar për të marrë pjesë në shpërndarjen e mandateve, pa dhënë numrin e tyre të votave të fituara.

Hapi pestë: konstatimi i rezultateve zgjedhore të listës së pjesëtarëve të popullit kroat

Në bazë të nenit 94 parag. 2 (2) të Ligjit për zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve përcaktohet nëse lista që në zgjedhje ka përfaqësuar pjesëtarët e popullit kroat ka arritur rezultatin që 0,35% të votave të vlefshme, me çka fiton të drejtën për një mandat deputeti.

Hapi i gjashtë: konstatimi i rezultateve zgjedhore të listës së popujve pakicë

Sipas kësaj baze, vetëm listat e pakicave që nuk kanë kaluar pragun zgjedhor shfrytëzojnë këtë mekanizëm të diskriminimit pozitiv. Në kuadër të përcaktimit të rezultateve të listave zgjedhore të popujve pakicë, ekzistojnë dy faza të procedurës: e para është faza ku konstatohet numri i tërësishëm i votave që kanë realizuar listat zgjedhore, ta zëmë, lista e pjesëtarëve të pakicës shqiptare në Mal të Zi. Në fazën e dytë, konform dispozitës së parag. 1 të Ligjit për zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve konstatohet se cilat lista nuk kanë marrë 3% të votave të vlefshme.

Për të fituar të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e mandateve, sipas dispozitës së nenit 94 parag. 2 të Ligjit për zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve, këto lista individualisht duhet të marrin së paku 0,7% të votave të vlefshme. Pas kësaj, rezultatet zgjedhore, përkatësisht votat e fituara të listave që kanë marrë mbi 0,7% mblidhen përmes mbledhjes së thjeshtë dhe kështu arrihet deri të formimi i rezultateve të listës së përbashkët zgjedhore të pakicës përkatëse.

Hapi i shtatë: krijimi i listës zgjedhore të krejt listave zgjedhore që kanë fituar të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e mandateve

Pas konstatimit të rezultateve zgjedhore të të gjitha listave, konstatimit të listave zgjedhore që kanë kaluar pragun zgjedhor si dhe konstatimit të listave të pjesëtarëve të popujve pakicë (kroatëve, shqiptarëve dhe të tjerëve), atëherë kalohet në krijimin e listës së përbashkët në të cilën jepen krejt listat që kanë marrë pjesë në shpërndarjen e mandateve. Këtu duhet pasur parasysh se kështu ndahen 80 mandate, kurse një mandat gjatë procedurës i ndahet listës së anëtarëve të popullit kroat. Ky mandat nuk ndahet me përdorimin e metodës d'Hondt, por ndahet në momentin që konstatohet se lista në fjalë ka marrë së paku 0,35% të votave dhe, për pasojë, konsiderohet si mandat i rezervuar, për dallim nga mandatet e listës së përbashkët të popullit shqiptar mandatet e së cilës shpërndahen me zbatimin e metodës në fjalë. Krahas emrave të listës jepet numri tërësishëm i votave që ka marrë secila listë, përkatësisht numri i përbashkët i votave që ka marrë lista e përbashkët e pakicës shqiptare.

Hapi tetë: caktimi i numrit të mandateve

Hapi i parë në procedurën e përllogaritjes së numrit të mandateve që merr secila listë individuale është përcaktimi i koeficienteve. Konform nenit 95 të Ligjit mbi zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve, numri i mandateve që fiton një listë individuale përcaktohet ashtu që numri i tërësishëm i votave që ka fituar secila listë zgjedhore në njësinë zgjedhore pjesëtohet me pjesëtues 1, 2, 3 dhe kështu me radhë, deri te numri 80 (aq sa është numri i deputetëve që zgjidhen me këtë metodë). Në këtë mënyrë, koeficientet e fituar kësisoj radhiten sipas madhësisë, ku merret parasysh numri i madhësive aq sa ka këshilltarë përkatësisht deputet që zgjidhen.

Në fund fare kalohet në përcaktimin e numrit përfundimtar të mandateve që kanë fituar listat individuale në bazë të qasjes së sipërshënuar metodologjike.

12.6. Masat institucionale për ngritjen e pjesëmarrjes së grave

Edhe në Mal të Zi afirmohet baraspesha e caktuar apo pariteti mes gjinive. Me ndryshimet e ligjit zgjedhor në vitin 2011, për herë të parë është futur kuota gjinore për gjininë më pak të përfaqësuar në listat zgjedhore të Malit të Zi. Si kusht për verifikimin e listës nga organet e administratës zgjedhore është futur parimi sipas të cilit në listat e kandidatëve duhet të jenë së paku 30% kandidatë të gjinisë më pak të përfaqësuar. Kjo bëhet me aplikimin e sistemit "zip" që do të thotë se çdo i treti kandidat duhet të jetë grua. Me ndryshimet e fundit në ligjin zgjedhor të **Malit të Zi**, me qëllim të realizimit të parimit të barazisë, është miratuar një dispozitë sipas së cilës, krahas detyrimit për futjen në listë të së paku 30% të gjinisë më pak të përfaqësuar, është futur edhe detyrimi që në listën zgjedhore të figurojë mes çdo katër kandidatëve një i gjinisë më pak të përfaqësuar (katër vendet e para, katër vendet e dyta dhe kështu deri në fund të listës). Në këtë ndryshim ligjor është futur edhe dispozita që thotë se kur këshilltarit apo deputetit nga gjinia më pak e përfaqësuar i ndërpritet mandati, atëherë i pari kandidat në listë zgjedhore nga radha e gjinisë më pak të përfaqësuar e zëvendëson atë.

12.7. Zgjedhjet lokale

Për zgjedhjet lokale me relevancë është KMZi, Ligji mbi zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve dhe Ligji mbi vetëqeverisjen lokale. KMZi definon parimet themelore të vetëqeverisjes lokale, përfshirë përfaqësimin në nivel lokal të vullnetit politik, njëjtë si në Kosovë dhe vendet përreth. Edhe për këshilltarë vlen sistemi i njëjtë proporcional, kurse për kryetar të komunës vlen sistemi mazhoritar, njëjtë si në Kosovë. Zgjedhjet për këshilltarë komunalë (kuvendet komunale) dhe për kryetar të komunës i shpall Presidenti i Malit të Zi. Për aspektet tjera, pak a shumë organizimi dhe funksionimi i zgjedhjeve lokale është i njëjtë si në Kosovë. Për këtë arsye nuk e shohim të arsyeshme t'i përsërisim gjërat që kanë dallime jokonceptuale dhe krejtësisht të natyrës teknike. Ajo që vlen për Kosovën vlen edhe për vendet përreth saj, jo vetëm kur flitet për Malin e Zi dhe anasjelltas, sepse koncepti i organizimit dhe funksionimit të legalitetit dhe legjitimitetit të zgjedhjeve dhe të drejtës zgjedhore lokale është i njëjtë.

12.8. Zgjedhjet presidenciale

Edhe në Mal të Zi, Presidenti zgjidhet në zgjedhje të drejtpërdrejta. Për këtë janë relevantë dy struktura normative: **KMZi** dhe **Ligji për zgjedhjen e Presidentit**, i cili është shumë i shkurtër dhe me pak dispozita.

KMZi definon në parim natyrën juridike-kushtetuese të pozitës së shefit të shtetit, i cili zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët për pesë vjet, me kufizimin që mund ta ushtrojë të njëjtën detyrë vetëm dy herë.[120] Njëri nga presidentët e Malit të Zi, presidenti **Filip Vujanoviq**, nominalisht ka qenë president nga viti 2003 deri më 2018, përkatësisht tri herë: herën e parë nga viti 2003-2008; herën e dytë nga 2008 – 2013 dhe herën e tretë nga vitit 2013 - 2018. **Gjykata Kushtetuese e Malit të Zi** (GJKMZi) ka konstatuar se nuk ka qenë shkelje e KMZi, sepse mandati i tij i parë në vitin 2003 ka qenë deri në qershor të vitit 2006, në kohën kur **Mali i Zi** nuk ka qenë shtet sovran dhe i pavarur, por pjesë e bashkësisë shtetërore Serbi-Mali i Zi. Pas vitit 1992, Mali i Zi ka zgjedh rrugën e shtetit të përbashkët me Serbinë, i njohur si Republika Federale e Jugosllavisë, e cila, më 2003, në bazë të **Marrëveshjes së Beogradit** të 14 marsit 2002, është shndërruar në **Bashkësinë Shtetërore Serbi Mali i Zi** (BSHSMZi) dhe ka zgjatur deri më 3 qershor të vitit 2006, kur **Mali i Zi** u shpall shtet sovran dhe i pavarur në bazë të një referendumit të 21 majit të atij viti. Kjo ka nënkuptuar se në vitin 2006, vit pavarësimit të Malit të Zi, **Filip Vujanoviq** ka qenë në mandatin e tij të tretë. Lidhur me këtë ka ekzistuar një debat i gjallë në Mal të Zi, për dhe kundër vendimit të **GJMZi**, i cila është dhënë para zgjedhjeve presidenciale të vitit 2013, që nuk numëronte mandatin e kaluar para pavarësimit të këtij vendi, përkatësisht që thoshte se vitet 2008-2013 ishin vitet e mandatit të tij të parë, në ndërkohë që në vitet 2006-2008 ai kishte shërbyer vetëm si shef **de facto** i shtetit malazez.

[120] Cf. neni 97.1 i **KMZi**.

KMZi në mënyrë shprehimore normon mënyrën dhe kushtet e zgjedhjes së Presidentit të Malit të Zi, i cili zgjidhet në zgjedhje të përgjithshme, me votim të fshehtë, në bazë të së drejtës së përgjithshme e të barabartë të zgjedhjes. Për President mund të zgjidhet shtetasi i Malit të Zi, që ka vendbanim në Mal të Zi së paku dhjetë vjet në 15 vitet e fundit. Zgjedhjet për president të Republikës i shpall kryetari i Kuvendit.[121] Në KMZi, sikundër shihet, nuk ekziston një dispozitë që kërkon moshën e caktuar për të qenë kandidat për president të Malit të Zi, që nënkupton se mjafton mosha madhore. Një gjë të tillë nuk e kërkon as **Ligji për zgjedhjen e Presidentit të Malit të Zi**, që normon në detaje procedurën e kandidimit dhe zgjedhjes së Presidentit të Republikës. President zgjidhet kandidati që në raundin e parë fiton më shumë se gjysmën e votave të vlefshme të atyre që kanë votuar. Nëse ky nuk është rasti, atëherë kalohet në raundin e dytë dhe fiton kandidati me më shumë vota të vlefshme. Nëse votat janë të barabarta, atëherë brenda shtatë ditëve organizohet mes tyre një raund i tretë i zgjedhjeve dhe fiton kandidati që ka më shumë vota.[122]

13. Zgjedhjet në Serbi

13.1. Pasqyrë e zgjedhjeve të deritanishme parlamentare

Në Serbi në vitin 1990, njëjtë si në vendet tjera ish-komuniste, është futur sistemi shumëpartiak dhe parlamentarizmi, duke u braktisur sistemi i deriatëhershëm i delegimit që kishte qenë në fuqi në tërë territorin e ish-Jugosllavisë. Shtjellimet tona për këtë seksion bazohen kryesisht të librin e të drejtës kushtetuese të profesorit Slobodan P. Orloviq.[123]
Në fillim të pluralizmit politik, Serbia ka përqafuar sistemin mazhoritar, kurse në vitin 1992 vendi ka kaluar në sistemin proporcional. Më pastaj ka ardhur deri te korrigjimet e sistemit proporcional, në vitet 1997 dhe 2000, që sot janë në fuqi.

Sistemi mazhoritar, në fillim, ka ndarë territorin e Serbisë në 250 njësi zgjedhore njëmandatëshe. Pas dy viteve është kaluar në sistemin proporcional, siç u tha më sipër: Serbia u nda në nëntë njësi zgjedhore. Mandatet janë shpërndarë në bazë të **metodës së d'Hondt**, kurse pragu zgjedhor ligjor ka vlejtur për listat zgjedhore të partive politike, koalicionet dhe grupet e qytetarëve dhe ka qenë 5 %. Në zgjedhjet e rregullta të vitit 1997 (zgjedhjet e jashtëzakonshme qenë mbajtur në vitin 1993 sipas sistemit të njëjtë) ka ardhur deri të rritja e numrit të njësive zgjedhore në 29 sosh. Zgjedhjet e jashtëzakonshme të dhjetorit të vitit 2000 janë mbajtur pas rrëzimit formal nga pushteti të diktatorit serb **Slobodan Millosheviq** (Slobodan Milošević: 1941-2006) më 6 tetor të atij viti. Para këtyre zgjedhjeve, Serbia u shndërrua në një njësi zgjedhore, zgjidhje që edhe sot e kësaj dite ekziston. Përveç kësaj, këtu ka ardhur edhe deri te ndryshimi i kushteve teknike: është futur në përdorim spreji identifikues, kutitë e votimit të tejdukshme, e kështu me radhë.

Në vitin 2003 ka ardhur deri të ndryshimi i rregullave zgjedhore: është hequr pragu zgjedhor për partitë politike të pakicave kombëtare dhe është fshirë dispozita mbi marrjen e mandatit të deputetit nëse i pushon anëtarësimi në partinë politike që e ka kandiduar. Zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare janë mbajtur në fund të vitit të njëjtë.

Zgjedhjet e radhës janë mbajtur në fillim të vitit 2007, pas shpërbërjes së **BSHSMZi**. Në shtator të vitit 2006, Serbia ka nxjerrë Kushtetutën e re, si shtet sovran dhe i pavarur (KSerb), pas shpalljes së **Malit të Zi** shtet sovran dhe i pavarur. Rregullat zgjedhore janë ndryshuar ashtu që janë futur nënshkrimet e detyrueshme të listave zgjedhore me më së paku 10.000 votues. Kjo qe bërë me qëllim të zvogëlimit të listave zgjedhore që marrin pjesë në zgjedhje, por edhe reduktimin e partive politike. Zgjedhjet e rregullta parlamentare janë mbajtur më 2012. Për këto zgjedhje rregullat janë ndryshuar në atë drejtim që listat zgjedhore kanë qenë tërësisht të strukturuara ku mandatet u ndaheshin kandidatëve sipas radhitjes. Kjo ishte e ndryshme nga viti

[121] Cf. neni 96 i **KMZi.**
[122] Cf. neni 16 Cf. neni 17 i Ligji mbi zgjedhjen e Presidentit të Malit të Zi.
[123] Slobodan P. Orlović, *Ustavno pravo*. Drugo ispravljeno izdanje (Pravni fakultet Univerziteta Novi Sad: Novi Sad, 2019) (vetëm në alfabetin cirilik).

2011, kur mandatet ndaheshin sipas vullnetit të propozuesit të listës zgjedhore. Përveç radhitjes sa i përket ndarjes së mandateve, çdo i treti kandidat duhej të ishte nga gjinia më pak e përfaqësuar. Tani u hoqën edhe "dorëheqjet blanko", d.m.th. që kandidatët që ishin bërë deputetë dhe ndërronin partinë politike, humbnin mandatin. Kjo praktikë u braktis në këto zgjedhje. Sa i përket mbrojtjes së të drejtave zgjedhore, tani gjykata administrative u autorizua që t'i zgjidh kontestet zgjedhore. Edhe zgjedhjet e jashtëzakonshme të vitit 2014 e 2016 si dhe zgjedhjet e rregullta të vitit 2022 janë mbajtur sipas rregullave të njëjta.

13.2. Llojet e zgjedhjeve, burimet e të drejtës dhe e drejta zgjedhore

Në Serbi ekzistojnë katër lloje të zgjedhjeve të drejtpërdrejta për tri nivele të pushtetit. Në nivel qendror, Përveç zgjedhjeve për deputet të **Kuvendit të Serbisë**, mbahen edhe zgjedhjet për **President të Republikës**. Në nivelin e mesëm (regjional) të pushtetit ekzistojnë zgjedhjet për deputet të **Kuvendit të Krahinës Autonome të Vojvodinës** (KKV). Në nivelin lokal, së fundi, ekzistojnë zgjedhjet për këshilltarë të kuvendeve komunale dhe kuvendeve të qyteteve (brenda njësive të vetëqeverisjes lokale ekzistojnë zgjedhjet për këshilla të bashkësive lokale, mirëpo bashkësitë lokale nuk janë njësi të pushtetit lokal por forma të organizimit qytetar në baza interesi). Këtu duhet përmendur edhe zgjedhjet e drejtpërdrejta dhe zgjedhjet përmes "kuvendit të elektorëve" për këshillat nacionalë të pakicave kombëtare, të cilat janë trupa përfaqësuese të pjesëtarëve të pakicave të formuara me qëllim të realizimit të të drejtave për vetëqeverisje në kulturë, arsim, informim dhe përdorim zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të tyre. Këto zgjedhje normohen me ligj të veçantë dhe dispozita të veçanta nënligjore.

E drejta zgjedhore serbe rregullohet me **KSerb**, ligje dhe akte nënligjore. **KSerb** normon disa çështje të së drejtës materiale zgjedhore, njëjtë si në të gjitha vendet e rajonit dhe përtej, siç janë: kushtet e të drejtës së zgjedhjes numri i deputetëve popullorë, kohëzgjatja e mandatit, karakteristikat apo cilësitë e të drejtës së votës (e përgjithshme dhe individuale), natyra e zgjedhjeve (të lira dhe të drejtpërdrejta), cilësitë e votimit (i fshehtë dhe personal), natyra e mandatit të deputetit. Nga rregullat e të drejtës procedurale zgjedhore, **KSerb** ngërthen dispozitat mbi organin dhe kohën e shpalljes së zgjedhjeve. Me ligje më pas normohen në mënyrë të detajuar e drejta materiale dhe procedurale zgjedhore: Ligji mbi zgjedhjet e deputetëve popullorë (2022), Ligji mbi zgjedhjen e Presidentit të Republikës (2022), Ligji mbi zgjedhjet lokale (2007, me ndryshimet deri ne vitin 2020). Materien zgjedhore pjesërisht e rregullon edhe Ligji mbi regjistrin unik të votuesve (2009, me ndryshimet e vitit 2011). Nga aktet nënligjore, veçojmë vendimin për zgjedhjen e deputetëve të **KKV** (2014, me ndryshimet e vitit 2020), udhëzuesit, rregulloret, rregullat dhe vendimet e rekomandimet e ministrave kompetentë (të drejtësisë dhe administratës shtetërore), të trupave rregullatore për mediat elektronike, komisioneve zgjedhore republikane, krahinore dhe lokale. Në mesin e dispozitave nënligjore mund të veçohet udhëzuesi për zbatimin e zgjedhjeve, që e miraton **Komisioni Republikan Zgjedhor** (KRZ), dhe që përmban dispozita të detajuara mbi vetë procedurën zgjedhore. Ngjashëm me këtë veprojnë të gjitha komisionet qendrore zgjedhore në rajon (pa marrë parasysh emërtimin e saktë të tyre).
Njëjtë si në Kosovë dhe në vendet tjera në rajon, krahas strukturave normative primare si më sipër, si burime subsidiare të së drejtës zgjedhore serbe mund të përmenden edhe ato që normojnë fusha të tjera juridike. Këtu hyjnë: Ligji mbi procedurën e përgjithshme administrative (2016, me ndryshimet e vitit 2018), me të cilin pjesërisht rregullohet puna e organeve për zbatimin e zgjedhjeve (që sipas natyrës së tyre juridike janë organe të administratës), Kodi penal (2005, me ndryshimet e vitit 2019), që normon veprat penale lidhur me zgjedhjet, Kodi procedurës penale (2011, me ndryshimet e vitit 2011), Ligji mbi kundërvajtjet (2013, me ndryshimet e vitit 2013) që normon kundërvajtjet lidhur me zgjedhjet, Ligji mbi Gjykatën Kushtetuese (2007, me ndryshimet e vitit 2015).

E drejta aktive dhe pasive e zgjedhjes në Serbi është e barabartë nën kushtet të caktuara dhe e njëjtë për të gjitha llojet e zgjedhjeve. Me **KSerb** përcaktohet që çdo shtetas madhor dhe me aftësi veprimi ka të drejtën për të zgjedhur e të drejtën që të zgjidhet. Që të votohet në zgjedhje, përveç moshës madhore (18 vjeç), zotësisë së veprimit (shëndet psikik) dhe shtetësisë, nevojitet pasja e vendbanimit në Serbi dhe të qenurit i regjistruar në regjistrin e unik të votuesve. Përveç kësaj, për të drejtën pasive të zgjedhjes domosdo kër-

kohet që të plotësohet edhe kushti i përkrahjes së kandidaturës, që është i ndryshëm për tri nivelet e sipërshënuara të zgjedhjeve të drejtpërdrejta, si dhe ai i pasjes së vendbanimit në **Krahinën e Vojvodinës** apo në njësinë e vetëqeverisjes lokale.

13.3. Elementet themelore të sistemit zgjedhor

Nga viti 2014, kur sistemi i përzier zgjedhor i **Krahinës së Vojvodinës** u zëvendësua me sistem proporcional zgjedhor, në Serbi ekziston një nivelizim i sistemit zgjedhor në tri nivelet e trupave përfaqësues. Bëhet fjalë për sistemin proporcional zgjedhor me një njësi zgjedhore dhe me prag zgjedhor prej 5% (përveç për listat zgjedhore të pakicave kombëtare). Në nivel lokal, një njësi zgjedhore përfaqëson secila komunë, qytet si dhe **Qyteti i Beogradit**, kurse në nivel regjional, **Krahina e Vojvodinës** është një njësi zgjedhore. Deputetët për Kuvend të Serbisë gjithashtu zgjidhen në një njësi zgjedhore - **Republikën e Serbisë**.
Presidenti i Serbisë zgjidhet në nivel të krejt shtetit me **sistem mazhoritar**.
Në një njësi të madhe zgjedhore mund të realizohet me saktësi proporcioni mes votave të fituara dhe mandateve të marra. Sistemi zgjedhor me një njësi zgjedhore duket si më i përgjithshmi nga aspekti i barazisë së të drejtës së zgjedhjes, sepse lista zgjedhore që fiton më shumë vota nga të tjerët, proporcionalisht me këtë merr numrin më të madh të mandateve. Për të gjitha listat zgjedhore ekziston një prag zgjedhor prej 5 % të votave të përgjithshme të votuesve që kanë dalë në zgjedhje dhe kanë votuar, si në aspektin absolut ashtu edhe në atë relativ. Kjo nuk vlen për partitë e pakicave kombëtare. Në një njësi zgjedhore ku zgjidhen 250 deputetë popullorë, aq sa ka **Kuvendi Serbisë** me mbi 6 milionë votues, emrat e kandidatëve janë të panjohur. Këtë dilemë e kanë edhe vendet tjera përreth Kosovës. Për pasojë, edhe këtu votohet për partinë politike dhe kryetarin e saj. Emrat e kandidatëve edhe këtu nuk kanë ndonjë rëndësi të madhe. Kjo do të thotë se, praktikisht, edhe këtu votuesi nuk është i lirë për të zgjedhur përfaqësuesin e vet. Këtë liri votuesi e bartë në partinë politike, që do të thotë se ndrydhet cilësia e drejtpërdrejtshmërisë së votimit. Kjo filozofi bartet më pas në Kuvend, ku deputetët fare nuk ndiejnë përgjegjësi para votuesit, dilemë kjo që haset në secilin vend të rajonit përreth Kosovës. E njëjta dilemë aplikohet edhe në zgjedhjet për **KKV**, ku zgjidhen 120 deputetë dhe zgjedhjet lokale, ku zgjidhen mesatarisht nga 19 deri në 110 këshilltarë, gjithashtu në një njësi zgjedhore - komunë, qytet dhe **Qyteti i Beogradit**.

Sistemi proporcional serb është me **lista të mbyllura**, ku fuqia e partisë politike fokusohet në nominim, në fazën e përpilimit të listës zgjedhore. Ata që janë më lartë në listë, kanë shanse më të mira për fitim të mandatit, njëjtë si në vende tjera përreth Kosovës. E njëjta vlen edhe për listat zgjedhore për **KKV**, ani pse ato kanë më pak kandidatë në listë.

Për listat zgjedhore të partive politike të pakicave kombëtare nuk ka prag zgjedhor. Ato hyjnë në **Kuvendin e Serbisë**, **KKV** dhe në kuvendin komunal, të qytetit dhe të **Qytetit të Beogradit** nëse realizojnë pragun natyror zgjedhor. Për fitimin e statusit të partisë politike të pakicës kombëtare kërkohet plotësimi i kritereve formale – 1000 nënshkrime kundrejt 10 000 nënshkrimeve që kërkohen për partitë tjera dhe deklarimi në aktin e partisë politike që qëllim i veprimit të saj është përparimi dhe mbrojtja e të drejtave të pakicave.

Në Serbi zbatohet **metoda d'Hondt** e përllogaritjes, përkatësisht shndërrimit të votave në mandate. Numri i votave të fituara nga secila listë zgjedhore, e cila ka kaluar pragun zgjedhore prej 5%, pjesëtohet me numrat 1, 2, 3, deri në 250 (sa është numri i deputetëve).

Ekziston një regjistër unik i votuesve që vlen për krejt Serbinë, i cili azhurnohet sipas modaliteteve të njëjta që përditësohen regjistrat e votuesve në vendet përreth Kosovës. E njëjta vlen edhe për kontrollin e zgjedhjeve, që kryhet nga ana e organeve që zbatojnë zgjedhjet – komisionet zgjedhore dhe këshillat e votimit. Krahas tyre, pjesëmarrësit në procedurën e zgjedhjes, kandidatët dhe vetë votuesit kontrollojnë procesin zgjedhor. Të gjithë këta kanë të drejtë për të paraqitur mjete juridike për mbrojtjen e të drejtave zgjedhore dhe përgjithësisht për kontrollin e ligjshmërisë së procedurës zgjedhore: prapësimi apo kundërshtimi në komisionin zgjedhor dhe ankesa në **Gjykatën Administrative**. Edhe këtu afatet janë të shkurtra për real-

izimin e të drejtave zgjedhore. Lloj i kontrollit është edhe vëzhgimi i zgjedhjeve, njëjtë si në vendet tjera, si nga subjektet vendore ashtu edhe nga subjektet ndërkombëtare. Mjetet e informimit luajnë një rol të rëndësishëm në procesin zgjedhor dhe për këtë ekziston një rregullativë e dendur për të gjitha llojet e zgjedhjeve.

13.4. Realizimi i zgjedhjeve

13.4.1. Realizimi i zgjedhjeve për përfaqësues të popullit – veprimet zgjedhore

Procedura e zgjedhjes së deputetëve në mënyrë të detajuar normohet me Ligjin për zgjedhjen e deputetëve popullorë dhe udhëzimin për zbatimin e zgjedhjeve që miratohet para çdo palë zgjedhjesh. Këtë të fundit e nxjerr **KRZ-ja**. Zgjedhjet shpallen 90 ditë para mbarimit të mandatit të deputetëve aktual të Kuvendit të Serbisë. Ato i shpall Presidenti i Serbisë. Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme, ndërkaq, nxirret në të njëjtën kohë me dekretin për shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës. Afati për realizimin e zgjedhjeve është 60 ditë, si për zgjedhjet e rregullta ashtu edhe për zgjedhjet e jashtëzakonshme.

Veprim tjetër zgjedhor është dorëzimi i listave zgjedhore në **KRZ** nga ana e partisë së regjistruar politike, koalicionet e partive dhe grupet e qytetarëve. Listat zgjedhore duhet t'i plotësojnë kushtet ligjore, që janë afërsisht të njëjta si në Kosovë dhe vendet përreth. Në këtë fazë të procedurës zgjedhore, pra pas dorëzimit të listave dhe konstatimit se ato plotësojnë kushtet ligjore, formohen organet për zbatim të zgjedhjeve përmes zgjerimit të përbërjes së rregullt të **KRZ-së** (kryetarin dhe 16 anëtarë, me mandat katërvjeçar, i zgjedh Kuvendi i Serbisë), formohen këshillat e votimit (me vendim të **KRZ-së**). Për çdo palë zgjedhje, KRZ-ja zgjerohet me nga një përfaqësues të listës zgjedhore. Këshilli i votimit ka së paku kryetarin dhe dy anëtarë kurse në përbërjen e zgjeruar edhe me nga një anëtar nga lista zgjedhore. KRZ-ja cakton vendvotimet (me propozim të organeve të administratës lokale), sipas kriterit 100 (përjashtimisht edhe më pak) deri në 2.500 votues për një vendvotim. Regjistri i votimit përditësohet 48 orë para zgjedhjeve. Paralel me këto veprime zgjedhore, **KRZ-ja** përgatitë materialin zgjedhore. Prodhimi i tij, shpërndarja dhe gjërat tjera lidhur me të janë thuajse të njëjta si në Kosovë dhe vendet përreth. Gjithashtu, votimi bëhet përmes identifikimit dhe në vendin ku është i regjistruar. Për njerëz të verbër, invalid dhe analfabet vlejnë standardet e njëjta si në Kosovë dhe vendet përreth. E njëjta vlen, **mutatis mutandis**, edhe për procedurën e konstatimit të rezultatit të zgjedhjeve dhe verifikimit të tyre përfundimtar.

13.4.2. Realizimi i zgjedhjeve për Presidentin e Republikës – veprimet zgjedhore

Procedura për zgjedhjet presidenciale në Serbi normohet me Ligjin për zgjedhjet e Presidentit të Republikës dhe udhëzimin për zbatimin e zgjedhjeve për President të Republikës, e cila miratohet dhe ndryshohet, sipas nevojës, para çdo zgjedhjeve. Në mënyrë të përshtatshme zbatohen edhe dispozitat e Ligjit për zgjedhjen e deputetëve popullorë.

Procedura për zgjedhjen e Presidentit të Serbisë nis me vendimin për shpalljen e zgjedhjeve të cilën e nxjerr kryetari i Kuvendit të Serbisë. Afatet për zgjedhjet e rregullta pesëvjeçare janë të përcaktuara me **KSerb** – 90 ditë para mbarimit të mandatit dhe duhet të kryhen brenda 60 ditëve (neni 114). Zgjedhjet e jashtëzakonshme, kur presidentit i ndërpritet mandati më herët për shkak të dorëheqjes ose shkarkimit, shpallen dhe duhet të mbahen më së largu tre muaj pas pushimit të mandatit. **KSerb** thotë se mbahen zgjedhjet brenda tre muajve, që nënkupton diçka tjetër prej shprehjes përfundojnë zgjedhjet. Afati prej tre muajve vlen edhe atëherë kur mandati i Presidentit të Serbisë është vazhduar si pasojë e gjendjes së jashtëzakonshme apo të luftës dhe fillon të rrjedh nga dita e pushimit të gjendjes së tillë. Në vendimin që botohet në Gazetën Zyrtare të Serbisë, caktohet dita e votimit (ditë e shtunë ose e diel) dhe koha kur fillojnë të rrjedhin afatet për ndërmarrjen e veprimeve zgjedhore.

Veprimi i parë zgjedhor është paraqitja e kandidaturës në **KRZ**. Procedura e paraqitjes së kandidatëve është e ngjashme me procedurën e paraqitjes së listave zgjedhore për zgjedhjet parlamentare. Kandidatë për president mund të propozojnë partitë e regjistruara politike, koalicionet e partive politike dhe grupet e qytetarëve

(më së paku dhjetë vetë). I njëjtë si për zgjedhje parlamentare është edhe numri i nevojshëm i nënshkrimeve të vërtetuara në përkrahje të kandidaturës – 10 000 votues. Propozimi duhet të përmbajë të dhënat personale për kandidatin – emrin dhe mbiemrin, vendbanimin, numrin unik të amzës dhe dokumentet siç janë: deklarata mbi pranimin e kandidaturës, dëshmi për shtetësinë dhe të drejtën e zgjedhjes, nënshkrimet e vërtetuara në mbështetje të kandidaturës, marrëveshjen e koalicionit ose marrëveshjen për themelimin e grupit të qytetarëve. Kandidimi është vullnetar, që do të thotë se në kohën e ndërmarrjes së këtij veprimi zgjedhor mund të vije deri te heqja dorë nga kandidatura, deri në ditën e vërtetimit të listës së kandidatëve.

Njëjtë si te rasti i listës për deputetë, nëse kandidatura plotëson kushtet e përcaktuara, **KRZ-ja** e shpallë atë, në të kundërtën jep afat shtesë të përshtatshëm për mënjanimin e të metave të kandidaturës. Lista e krejt kandidatëve vërtetohet më së voni 15 ditë para zgjedhjeve dhe botohet në Gazetën Zyrtare të Serbisë, kurse vetë renditja e kandidatëve përcaktohet me short.

Përveç **KRZ-së** edhe organet tjera marrin pjesë në ndërmarrjen e veprimeve zgjedhore para ditës së zgjedhjeve, gjatë dhe pas votimit, në mënyrë të njëjtë si në zgjedhjet parlamentare. Ato janë: këshillat e votimit, trupat punues të **KRZ-së** në njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe koordinatorët e **KRZ-së**. Përditësimi i regjistrit të votuesve, përgatitja dhe sigurimi i materialit zgjedhor, rregullimi dhe përgatitja e vendvotimit dhe vet votimi janë njëjtë të normuara si edhe për zgjedhjet parlamentare.

Pas mbylljes së vendvotimit kalohet në konstatimin e rezultatit të zgjedhjeve. Së pari numërohen dhe ndahen fletëvotimet e papërdorura, pastaj konstatohet numri votuesve që kanë votuar, hapet kutia e votimit, verifikohet lista kontrolluese, ndahen fletëvotimet e vlefshme nga ato të pavlefshme, konstatohet numri i votave që ka fituar secili kandidat dhe krejt kjo futet në procesverbal mbi punën e këshillit të votimit, të cilin e nënshkruajnë krejt anëtarët. Materiali zgjedhor më pas dërgohet në KRZ (përmes trupave të KRZ-**së** në njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe koordinatorëve të KRZ-**së**), kurse materiali zgjedhor nga jashtë dërgohet me postë diplomatike. Deri këtu procedura është gati e njëjtë me zgjedhjet parlamentare.

Ajo që dallon zgjedhjet presidenciale substancialisht nga ato parlamentare ka të bëjë me faktin se konstatimi i rezultateve zgjedhore bëhet sipas sistemit mazhoritar – numrit të votave që secili kandidat ka fituar, që rrjedh nga vërtetimi i numrit të tërësishëm të votuesve, votuesve që kanë votuar dhe numrit të fletëvotimeve (të papërdorura, të pavlefshme dhe të vlefshme). Fitues është kandidati që ka fituar shumicën e votave të atyre që kanë votuar (një formë e butë e shumicës absolute). Nëse asnjëri kandidat nuk fiton këtë shumicë, pra nuk ka fitues në raundin e parë, votimi përsëritet brenda 15 ditëve, në raundin e dytë që e cakton KRZ-ja. Në mes të dy raundeve kryhen veprimet zgjedhore si vijon: përditësimi i regjistrit të votuesve, përgatitja, dorëzimi dhe sigurimi i materialit zgjedhor. Renditja e kandidatëve në fletëvotim për raundin e dytë të zgjedhjeve përcaktohet sipas numrit të votave të fituara në raundin e parë. Në zgjedhjet e përsëritura marrin pjesë dy kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të votave në raundin e parë. Për President të Serbisë zgjidhet kandidati që ka fituar më së shumti vota.

Teorikisht, edhe këtu ka mundësi që më shumë kandidatë, për nga numri i votave të fituara në raundin e parë, mbajnë vendin e parë ose të dytë së bashku. Në një rast të tillë, në raundin e dytë do të merrnin pjesë më shumë kandidatë, kurse fitues do të ishte kandidati që fiton më së shumti vota. Nëse kandidatët sërish kanë numrin e njëjtë dhe, njëkohësisht, numrin më të madh të votave, atëherë votimi përsëritet (raundi i tretë).

KRZ-ja konstaton rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve dhe i shpall në Gazetën Zyrtare brenda 96 orëve nga mbyllja e vendvotimeve (pas raundit të parë ose të dytë të zgjedhjeve). Para shpalljes së rezultateve zgjedhore duhet të kenë përfunduar të gjitha procedurat e mbrojtjes së të drejtave zgjedhore pranë **KRZ-së** dhe **Gjykatës Administrative**.

13.4.3. Realizimi i zgjedhjeve për deputetët e KKV-së

Procedura e realizimit të zgjedhjeve në **Krahinën e Vojvodinës** përcaktohet në mënyrë të detajuar me vendimin e KKV-së, udhëzimin për zbatimin e zgjedhjeve që sillet para zgjedhjeve dhe, në mënyrë të përshtatshme, zbatohen edhe ligjet zgjedhore (mbi zgjedhjen e deputetëve dhe mbi regjistrin unik të votuesve).

Në Statutin e **Krahinës së Vojvodinës**, si akti më i lartë në **Vojvodinë**, gjenden dispozitat mbi shpalljen e zgjedhjeve, numrin e deputetëve që zgjidhen (120), mënyra e votimit (e fshehtë), natyra e zgjedhjeve (të drejtpërdrejta) dhe kohëzgjatja e mandatit të deputetit (katër vite).

Veprimi i parë zgjedhor edhe këtu nis me shpalljen e zgjedhjeve, që i bën kryetari i KKV-së 90 ditë para mbarimit të mandatit të deputetëve ekzistues. Zgjedhjet kryhen brenda 60 ditëve në vijim (afatet janë të njëjta si për zgjedhjet parlamentare në Serbi). Vendimin për shpalljen e zgjedhjeve, kryetari i **KKV**-së e sjell brenda 30 ditëve nga dita e ndërprerjes së parakohshme të mandatit të **KKV** (mandati pushon me vetëshpërndarje dhe sipas fuqisë së Statutit). Në vendim përcaktohet data e zgjedhjeve dhe afatet për ndërmarrjen e veprimeve zgjedhore.

Veprimin zgjedhor të paraqitjes së listave të kandidatëve për deputetë në **Komisionin Zgjedhor Krahinor** (KZK) e ndërmarrin partitë e regjistruara politike, koalicionet e partive politike, grupet e qytetarëve (së paku 10 qytetarë), si dhe koalicionet mes partive politike dhe grupit të qytetarëve. Edhe këtu veprimet pasuese zgjedhore janë të njëjta si në zgjedhjet parlamentare, Përveç që numër më i vogël kërkohet për mbështetje të kandidaturave. Pas konstatimit se i kanë plotësuar kushtet formale, **KZK**-ja shpall listën unike zgjedhore, që përfshinë të gjitha listat me të dhënat për kandidatët, e cila botohet në Gazetën Zyrtare të **Krahinës së Vojvodinës**.

Edhe veprimi zgjedhor i formimit të organeve për zbatimin e zgjedhjeve, konceptualisht është i njëjtë për zgjedhjet për deputetë në **KKV**. Dallimet janë teknike dhe lidhen me afate e çështje të tjera që nuk kanë rëndësi për shtjellimin tonë të mëtutjeshëm. E njëjta vlen për veprimin zgjedhor të përditësimit të regjistrave të votuesve, përgatitjes dhe dërgimit të materialit votues, mënyrës së votimit, konstatimit të rezultatit përfundimtar dhe certifikimit të zgjedhjeve dhe çështjet të tjera që kanë të bëjnë me zgjedhjet për KKV-në.

13.4.4. Realizimi i zgjedhjeve lokale – veprimet zgjedhore

Procedura e realizimit të zgjedhjeve lokale në Serbi normohet me Ligjin për zgjedhjet lokale dhe udhëzimin mbi zgjedhjet e këshilltarëve që nxirret nga komisionet zgjedhore komunale dhe të qyteteve. Zgjedhjet lokale i shpall kryetari i Kuvendit të Serbisë me dy kufizime kohore: e para, zgjedhjet duhet të kryhen më së largu 30 ditë para mbarimit të mandatit të këshilltarëve aktualë; dhe, e dyta, nga dita e shpalljes deri te dita e mbajtjes së zgjedhjeve nuk mund të kalojnë më pak se 45 e më shumë se 60 ditë. Kryetari i Kuvendit shpall zgjedhjet për krejt njësitë e vetëqeverisjes lokale ose vetëm për ato në të cilat ka skaduar mandati i këshilltarëve ekzistues. Në vendimin për shpalljen e zgjedhjeve jepet koha dhe dita nga e cila nis të rrjedhin afatet për ndërmarrjen e veprimeve zgjedhore. Nëse zgjedhjet lokale mbahen në të njëjtën ditë me zgjedhjet parlamentare, një sërë veprimesh zgjedhore që ndërmerren për zgjedhjet parlamentare prodhojnë efekte edhe në zgjedhjet lokale: formimi këshillave të vendvotimit, përcaktimi i vendvotimeve, përditësimi i regjistrit të votuesve, pranimi dhe dorëzimi i materialit zgjedhor.

Veprimin e parë zgjedhor, atë të caktimit të listave të kandidatëve për këshilltarë e ndërmarrin subjektet e njëjtë si te zgjedhjet parlamentare. Dallimet janë teknike, në afate dhe në detaje të tjera që nuk kanë relevancë për shtjellim të mëtejmë. E njëjta vlen edhe për veprimet tjera zgjedhore, siç janë formimi

i organeve zgjedhore, përditësimi i regjistrit të votuesve, barazisë së gjinisë më pak të përfaqësuar, caktimit të vendvotimeve, përgatitjes së materialit zgjedhor dhe dërgimit të tij në vendvotime, votimit, mbylljes së vendvotimeve, konstatimit të rezultatit zgjedhor dhe certifikimit të tij përfundimtar. Këtu komisionet zgjedhore formohen në nivel të njësisë së vetëqeverisjes – komunës ose qytetit. Brenda afatit prej 24 orëve nga mbyllja e vendvotimeve, komisioni zgjedhor shpall rezultatet e zgjedhjeve. Në 10 ditët në vijim, komisioni në fjalë ndan mandatet këshilltarëve të zgjedhur dhe u jep vërtetimin mbi zgjedhjen. Nëse komisioni zgjedhor ose Gjykata Administrative anulojnë zgjedhjet për shkak të parregullsive në zbatimin e zgjedhjeve, atëherë rezultatet përfundimtare shpallen pas përsëritjes së zgjedhjeve.

14. Institutet e demokracisë së drejtpërdrejtë – iniciativa popullore dhe referendumi

Zgjedhjet, ku qytetarët shprehen politikisht duke zgjedhur organet e pushtetit, paraqesin themelin e sistemit kushtetues të shteteve bashkëkohore. Këto shtete quhet **demokraci përfaqësuese**. Të pastra, **demokraci të drejtpërdrejta**, kanë ngelur përjetësisht vetëm si modele teorike, të pazbatueshme në praktikë për arsyet si vijon: mosinteresimi i popullsisë për një gjë të tillë, numri i madh i popullsisë, mungesa e dijes për vendimmarrje profesionale në punët shtetërore, pamundësia e organizimit të një vendimmarrjeje permanente popullore të vendimeve shtetërore.

Si shtet me demokraci gjysmë të drejtpërdrejtë mund të cilësohet ai shtet në të cilin kombinohen elementet e demokracisë përfaqësuese dhe demokracisë së drejtpërdrejtë. Në këtë lloj demokracie ekzistojnë zgjedhjet e drejtpërdrejta për organet përfaqësuese dhe, krahas tyre, ekzistojnë instrumente të vendimmarrjes së drejtpërdrejtë të të gjithë qytetarëve lidhur me punët shtetërore, në formën e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendosje mbi punët shtetërore në nivelet më të ulëta të pushtetit.

Format e vendosjes së drejtpërdrejt të qytetarëve janë **iniciativat popullore** dhe **referendumi**. Dallimi themelor mes këtyre dy instituteve të demokracisë së drejtpërdrejt është se te iniciativa popullore propozohet marrja e vendimit, kurse te referendumi vendoset, merret vendim. Përveç iniciativës popullore dhe referendumit, instrument i ushtrimit të drejtpërdrejtë të pushtetit janë edhe:

- **peticioni**;
- **plebishiti**; dhe
- **vetoja popullore**.

Iniciativa popullore është një institut i demokracisë së drejtpërdrejtë, përmes së cilës një numër i caktuar i qytetarëve me të drejtë zgjedhjeje mund të inicioj procedurën për ndryshimin e kushtetutës ose ligjit. Numri i zgjedhësve të nevojshëm për këtë caktohet me kushtetutë ose ligj. Krahas iniciativës popullore në nivel shteti ekziston edhe mundësia e nisjes së iniciativës popullore në nivelet e mesme të pushtetit (krahina, regjioni) dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale (vendore). Numri i nënshkrimeve të domosdoshme të qytetarëve është më i vogël në nivelet e ulëta të pushtetit, gjë që bën që iniciativat popullore të jenë aty më të shpeshta. Numri përcaktohen në **shifra absolute** të nënshkrimeve që duhen për suksesin e iniciativës (nga qindra deri në mijëra e milion sosh) ose në përqindje të numrit të tërësishëm të zgjedhësve në komunë, regjion, krahinë, njësi federale ose në shtetin si tërësi.

Iniciativa popullore ligjore, ajo që ndërmerret për nxjerrjen e ligjit, paraqet një mundësi kushtetuese që qytetarët të shkruajnë dhe propozojnë ligjin që duan. Ky instrument mundëson që paraqitësit e tij, përmes përfaqësuesve, të arsyetojnë projektligjin e tyre në parlament, të marrin pjesë në shqyrtimin e tij dhe të provojnë të bindin shumicën parlamentare që të votojnë për projektligjin e inicuesve. Edhe sikur mos të miratohet projektligji i propozuar, iniciativa popullore ka shkaktuar debat dhe shqyrtim parlamentar të çështjes që duhet normuar me ligj dhe, për pasojë, kjo mund të ketë ndikim në opinionin publik. Në disa sisteme kushtetuese, sado që mjaft rrallë, projektligji i propozuar mund të mira-

tohet në votim popullor, përkundër trupit përfaqësues (duke anashkaluar atë), si*ç* është rasti me disa kantone në **Zvicër** (tubimet e qytetarëve dhe komuniteteve rurale në kantonet **Apencel** (Appenzell) dhe **Glarus**.[124]

E ngjashme me iniciativën për nxjerrje të ligjit të ri apo amendamentim të ligjit ekzistues, sado që shumë më e rrallë, është **iniciativa kushtetuese** - për nxjerrje të kushtetutës së re apo amendamentim të kushtetutës ekzistuese. Ky raritet rrjedh nga fakti se për iniciativë popullore kushtetuese kërkon më shumë mbështetje qytetare, një numër shumë më të madh të qytetarëve që mund të iniciojnë këtë nismë popullore.

Iniciative popullore **formale** është ajo iniciativë që është e rregulluar asisoj që projektligji ka formën e ligjit (normat janë të ndara nëpër nene). E kundërt me këtë është iniciativa **joformale**, që përmban disa zgjidhje ligjore, ide të propozuesit dhe qëllimet që duhet të përmbush ligji në të ardhmen. Këtu çdo herë ka nevojë për redaktim nomo-teknik të propozimit ligjor.

Peticioni është e drejtë për t'iu drejtuar organeve të pushtetit dhe mund të çoj në vënien në lëvizje të procedurës për miratimin e ndonjë akti. Nëse organi shtetëror autorizon nisjen e procedurës, atëherë efekti i peticionit është i njëjtë me iniciativën popullore. Megjithatë, ekzistojnë disa dallime mes tyre: për peticion nuk kërkohet forma, ajo për më tepër mund të parashtrohet edhe gojarisht; peticionin zakonisht mund ta paraqes edhe një individ, kurse iniciativa popullore është një e drejtë kolektive; organi i pushtetit nuk ka detyrim për nisje të procedurës për miratimin e aktit të kërkuar me peticion dhe as detyrim për të arsyetuar refuzimin e peticionit. Ka vende në të cilat ekziston detyrimi kushtetues i organeve të pushtetit për të dhënë përgjigje në peticionin e paraqitur. Këtu në rend të parë kemi parasysh zgjedhjet kushtetuese të disa prej vendeve fqinje me Kosovën (Mali i Zi dhe MV). Si **peticion** konsiderohen edhe kritikat e vëna ndaj organeve të pushtetit, propozimet e disa zgjidhjeve teknike, ekonomike, teknologjike dhe të tjera që konsistojnë në inicimin e një aktivitetit të caktuar publik.

Në kuptimin më të përgjithshëm, **referendumi** është deklarim i drejtpërdrejtë politik i popullit lidhur me ndonjë akt ose çështje me karakter publik. Ai shërben si një instrument që përfshinë tri komponente: mobilizimin dhe pjesëmarrjen politike, legjitimimin dhe, së fundi, vendimmarrjen.[125] Në nivel nacional, në referendum nacional (popullor), deklarohen të gjithë qytetarët lidhur më ndonjë çështje të rëndësishme shtetërore, kurse në referendumin në njësinë federale, krahinë, regjion ose njësi të imët vetëqeverisëse, një pjesë e qytetarëve deklarohen mbi një çështje që ka rëndësi për atë territor dhe ata që jetojnë në të. Sipas rregullit në referendum votohet në një ditë. Qytetarët shprehin vullnetin e tyre politik lidhur me aktin që e ka miratuar organi i pushtetit ose aktin që duhet të miratohet në të ardhmen.

Referendumi është formalisht mënyra më demokratike e miratimit të një akti, sepse në të qytetarët vendosin drejtpërdrejtë. Ekzistojnë, megjithatë, të meta objektive të vendosjes me referendum, siç janë: mosekzistimi i lirisë së plotë të vendosjes me referendum, për shkak se pushteti ushtron presion të palejueshëm mbi qytetarët për mënyrën se si duhet të votohet; qytetari mesatar nuk ka kompetencën e duhur dhe njohuritë e mjaftueshme për të vendosur mbi çështjet e ndërlikuara dhe me pasoja afatgjate që janë vënë në referendum. Në shtetin antik, qytetarët e tillë kanë qenë kompetentë dhe të dijshëm dhe janë deklaruar me referendum, sepse u kanë takuar shtresave të përndritura të shoqërisë, kurse sot trupa zgjedhore është e ndryshme dhe përbëhet prej të gjitha shtresave shoqërore.

---

124 Cf. fusnotën nr. 2, **supra**, në këtë pjesë, dhe komentet tona dhe literaturën aty.

125 Cf. më shumë në përmbledhjen e thukët me trajtesa krahasuese të referendumit në kontesktin historik dhe aktual, Pier Vincenzo Uleri & Michael Gallagher (eds.), *The Referendum Experience in Europe.*

Referendumi, që quhet **plebishit**, është një mënyrë shumë e vjetër miratimit të vendimeve në shtet. Njihet që në shoqëritë antike greke e romake, kurse në kohën e shteteve moderne është përqafuar dhe zbatuar mjaft shpesh që nga koha **Napoleon Bonopartes** (Napoelon Bonaparte: 1769-1821) deri te **Sharl de Gol** (Charles de Gaulle: 1890-1970).[126] Sot më së shpeshti organizohet në **Zvicër**, nivelin e pushtetit qendror nacional dhe atë kantonal dhe atë për tema nga më të ndryshmet, siç janë, ta zëmë: mbi ndihmën sociale, ndërtimin e xhamive, pagesën e televizionit etj. Mjaft interesant është se disa shtete me rregullim kushtetues demokratik, nuk e njohin fare referendumin si mënyrë deklarimi të vullnetit politik të të gjithë qytetarëve për një akt juridik ose temë politike. I tillë është rasti, ta zëmë, me **SHBA**.[127]

Votimi në referendum është i ngjashëm me votimin në zgjedhje. Dallon nga ai vetëm për faktin se në referendum qytetarët deklarohen duke u përgjigjur në pyetjen e parashtruar konkrete me"për" ose "kundër", përkatësisht "po" ose "jo". Për këtë arsye pyetja e referendumit nuk guxon të jetë e dykuptimtë, sugjestive dhe shumë e komplikuar. Si shembull i pyetjes së dykuptimtë dhe sugjestive mund të merret ajo me referendumin mbi sovranitetin dhe pavarësinë e **MV** i datës 8 shtator 1991: "a jeni për Maqedoninë sovrane dhe të pavarur, me të drejtën për bashkim me shtetet e pavarura të Jugosllavisë?". Ngjashëm ka qenë edhe pyetja për referendumin e Kosovës për pavarësi e sovranitet në shtatorin e vitit 1991, që u diskutua më sipër. Zakonisht parashtrohet një pyetje, por ka edhe shembuj të tjerë. Kështu, ta zëmë, në referendumin për pavarësinë e **Kroacisë** më 19 maj 1991, kanë qenë dy pyetje: "a jeni për atë që Kroacia, si shtet sovran dhe i pavarur (...) mund të hyj në lidhjen e shteteve sovrane me republikat tjera?"[128] apo "jeni për atë që Kroacia të ngelet në Jugosllavi (...)?".[129] Ngjashëm me këtë ka qenë referendumi në **Irlandën e Veriut**, lidhur me statusin e saj, më 8 mars 1973, ku gjithashtu kanë qenë dy pyetje: "a jeni për atë që Irlanda e Veriut të ngelet pjesë e Britanisë

---

126 Cf. më shumë në Yves Beigbeder, "Referendum" *Max Planck Encyclopedias of International Law* [MPIL] (June 2011). Në internet chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://opil.ouplaw.com/view/10.1093/law:epil/9780199231 690/law-9780199231690-e1088?print=pdf (shikuar më 13 tetor 2022); Oliver Nikolić, "Referendum (sa posebnim osvrtom na Švajcarsku i Hrvatsku)" *Strani pravni život* God. 57 br. 1 (2013), fq. 13-25 në fq. 19; Matt Qvortrup, "The history of referendums and direct democracy". Në Laurence Morel and Matt Qvortrup (eds.), *The Routledge Handbook to Referendums and Direct Democracy* (Routledge: New York, 2018), fq 11-26.

127 Në SHBA ekzistojnë referendumet në nivel të shteteve anëtare. Kjo zakonisht lidhet me miratimin e ligjeve dhe amendamenteve kushtetuese të shteteve anëtare (përveç shtetit të Delauere që nuk e njeh referendumin kushtetues). Mungesa e referendumit federal vjen për disa arsye, por më kryesorja është ajo se etërit themelues të këtij shteti kishin pasur mosbesim të madh ndaj demokracisë së drejtpërdrejtë, duke e parë atë si formë të sundimit të rrugës. Ato donin një qeverisje ku, siç e kishin shprehur në "Letrat e Federalistit", asnjë degë e pushtetit nuk do të kishte aq pushtet sa për të rrëzuar tjetrën degë dhe asnjë shumicë nuk mund të përmbyste pakicën. Kjo shihet nga ndërtimi i elementeve të kontrollit dhe baraspeshës së pushteteve, përdorimit të Kolegjit Elektoral, natyra dydhomëshe e Kongresit të SHBA-ve dhe kështu me radhë, që dëshmojnë për përpjekjet e pandalura për mbrojtje të pakicës.Një tjetër arsye pse mungon referendumi ka të bëj me faktin se, ligjërisht, pushteti federal nuk ka fort punë me qytetarët, me të cilët merret pushtetit i shteteve anëtare apo një nivel më i ulët – niveli i komunitetit. Qeveria federale është ndërtuar në mënyrë të atillë kushtetuese që merret me dy fusha të gjëra: rregullimin e marrëdhënieve mes shteteve anëtare dhe marrëdhënieve me shtetet e huaja. Shprehja "krejt politika është lokale " më së miri e shpreh këtë, sepse çdo qytetar amerikan ka për të dhënë përgjigje në votë lidhur me tri pyetje: e para, kend ata duan ta kenë përfaqësues në Dhomën e përfaqësuesve të Kongresit Amerikan; e dyta, kend ata duan ta kenë përfaqësues të shtetit të tyre në Senat; dhe, së fundi, kujt ata duan t'ia japin votën e Kolegjit Elektoral të shteti të tyre. Asnjëra prej këtyre përgjigjeve nuk tejkalon nivelin e shtetit anëtar të SHBA.Së fundi, ekziston arsyeja e madhësisë. Zvicra, që ka një demokraci të drejtpërdrejtë shumë të gjallë, ka 8 milion popullësi, kurse SHBA 320 milion, 40 herë më shumë se populli Zvicrës. Kjo dilemë ka ekzistuar që nga kohërat e vjetra dhe, siç e kemi parë në diskutimin tonë më heret, është trajtuar edhe nga dijetarë të ndryshëm si një shkak për mosdominim të referendumeve dhe formave të tjera të demokracisë së drejtpërdrejtë në botën bashkëkohore.

128 Në këtë pyetje 93.24% kanë thënë po, kurse vetëm 4.15% kanë qenë kundër. Cf. "Izvješće o provedenom referendumu". *Republička komisija za provedbu referenduma*. 22. svibnja 1991. Në internet:https://web.archive.org/web/20120227183944/http://www.izbori.hr/arhiva/pdf/1991/1991_Rezultati_Referndum. pdf (shikuar më 13 tetor 2022).

129 Në këtë pyetje 5.38 për qind kanë thënë po, kurse 92.18% kanë qenë kundër. Ibid.,

së Madhe?",[130] apo "për atë që ajo t'i bashkohet Republikës së Irlandës jashtë Britanisë së madhe?".[131]

Përveç referendumit në nivel nacional (shtetëror) dhe në nivelet më të ulëta dhe referendumeve më një ose disa pyetje, mund të dallohen edhe disa lloje të tjera të referendumeve, të cilat i trajtojmë në vijim.[132] Sipas kohës në të cilën të cilën duhet të miratohet akti për të cilin kërkohet deklarimi qytetarëve, ekziston **referendumi paraprak** (para nxjerrjes së aktit) dhe **referendumi i mëpastajmë** (pas nxjerrjes së aktit).

Sipas efektit juridik që prodhon ndaj aktit, referendumet ndahen në **referendume konstitutive** dhe **referendume abrogative**. Më të parat krijohet akti apo lind çështja, me të dytin prishet çështja apo akti. Dy këto referendume janë të mëpastajme.

Sipas **fuqisë juridike**, përkatësisht sipas detyrimit që prodhon vendimi i miratuar me referendum, referendumet mund të jenë të detyrueshme, sepse detyrojnë organet e pushtetit për të vepruar sipas deklarimit të shprehur të qytetarëve, dhe këshillëdhënëse, kur vetëm merret në dijeni mendimi i shprehur i qytetarëve në referendum lidhur me një akt ose çështje.

Sipas **bazës juridike**, përkatësisht bazuar në atë nëse ekziston detyrimi për të shpallur, referendumi mund të jetë **i detyrueshëm**, për shkak se duhet të shpallet (ta zëmë, për amendamentimin e kushtetutës ose nxjerrjen e kushtetutës së re) dhe **fakultativ**, kur nuk ekziston detyrimi shpalljes së tij. Ky i fundit shpallet kur organet e pushtetit dëshirojnë të ndajnë përgjegjësinë politike lidhur me ndonjë çështje ose akt. Sipas fuqisë së tyre juridike, ndërkaq, dy këto lloje të referendumit janë të detyrueshme.

Sipas shumicës që nevojitet për miratimin e vendimit, referendumi mund të jetë me një **shumicë të rreptë** ose me një **shumicë të butë**. Kur për vendimin referendumian kërkohet shumica nga numri përgjithshëm i votuesve të regjistruar, atëherë bëhet fjalë për referendum më shumicë të rreptë. Si referendum me shumicë të butë konsiderohet ai kur vendimi merret me shumicën e votuesve që kanë votuar në referendum. Vlefshmëria e referendumit më një shumicë të butë mund të jetë e kushtëzuar nga një dalje minimale e votuesve në referendum (ta zëmë, më së paku shumica e votuesve të regjistruar) ose, për të pasur sukses referendumi, mund të kërkohet dalja në votim e një shumice të kualifikuar (ta zëmë, së paku 55% e atyre që dolën në referendum për pavarësinë e **Malit të Zi** në vitin 2006).

Quhet **referendum kushtetues** ai në të cilin qytetarët deklarohen mbi amendamentimin ose nxjerrjen e kushtetutës së re. Si **referendum ligjor**, ndërkaq, konsiderohet ai në të cilin qytetarët deklarohen për ligjin ekzistues apo për atë që duhet të nxirret. Një formë e veçantë e referendumit të mëpastajmë dhe të detyrueshëm është **vetoja popullore**. Në të vërtetë te vetoja popullore bëhet fjalë për kushtin zgjidhës, që prodhon pasoja të atilla ku akti konsiderohet se nuk është nxjerrë fare nëse deklarimi popullor ka qenë kundër tij.

Si formë e posaçme e vendosjes së drejtpërdrejtë, **plebishiti** konsiston në votimin e drejtpërdrejtë dhe të fshehtë të qytetarëve mbi një çështje të caktuar, e cila mund të jetë nga fusha e rregullimit të brendshëm dhe politikës së brendshme (vendosja për formën e qeverisjes, mbi pushtetin e një personaliteti etj.) ose, më shpesh, nga fusha e të drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare (vendosje

130 98,9 % kanë thënë po, sepse nacionalistët katolik (irlandezët) e kanë bojkotuar. Cf. David Torrance, "Taking the border out of politics – the Northern Ireland referendum of March 1973". *The Constitution Unit* November 21, 2019. Në internet: https://constitution-unit.com/2019/11/21/taking-the-border-out-of-politics-the-northern-ireland-referendum-of-march-1973/ (shikuar më 13 tetor 2022).

131 Vetëm 1.1 për qind kanë thënë, Ibid.,

132 Oliver Nikolić, "Referendum (sa posebnim osvrtom na Švajcarsku i Hrvatsku)", fq. 15-19.

për bashkimin e një territori shtetit të caktuar, mbi vetëvendosjen etj.). Disa e konsiderojnë plebishitin si lloj të referendumit në fushën e të drejtës ndërkombëtare, por për shumicën e teorikëve ai ngelet një institucion i demokracisë së drejtpërdrejtë që qartësisht dallon nga referendumi. Në parim, te plebishiti nuk bëhet fjalë aq shumë për deklarim për një tekst, sa për thirrje popullit që të jep besimin e tij, pak a shumë të heshtur, një njeriu që të konfirmoj pushtetin e vet. Këtë e konfirmon praktika kushtetuese dhe politike në Francë përgjatë shekujve XIX dhe XX, vendi ku ka lindur dhe është përdorur më së shpeshti.[133] Mjafton të përmendim, ta zëmë, rastin e **Sharl de Gol**, i cili ka konsideruar se referendumi për shndërrimin e Senatit francez në trup këshillëdhënës i datës 27 prill 1969 ka paraqitur, në të vërtetë, një **plebishit** lidhur me qëndrimin e tij në pushtet. Pas mungesës së përkrahjes për këtë ide me dështimin e referendumi, ai ka dhënë dorëheqje.

Në shtetet evropiane, kohëve të fundit referendumet janë mbajtur më rastin e përcaktimit të statusit juridik-kushtetues të shteteve: në hapësirat e ish-**Jugosllavisë** gjatë shpërbërjes së saj (1991-2006), mbi ruajtjen dhe reformimin e ish-**Bashkimit Sovjetik** (17 mars 1991), në shtetet që i janë bashkuar **BE**-së apo kanë dalë prej saj (në fakt, referendumi i parë në **Britaninë e Madhe** ka qenë lidhur me anëtarësimin e saj në BE më 5 qershor 1975, dhe ka përfshirë të gjitha bashkimet ekonomike dhe tregun e përbashkët evropian, kurse i fundit për dalje nga BE më 23 qershor 2016, i njohur si **BREXIT**), mbi shkëputjen nga shteti (më 30 tetor 1995, **Kuebeku** në Kanada ka dështuar në referendumin për shkëputje, siç pat dështuar edhe **Skotlanda** më 18 shtator 2014; në **Mal të Zi**, ndërkaq, referendumi për shkëputje ka qenë i suksesshëm dhe është mbajtur më 21 maj 2006), mbi martesat e personave të gjinisë së njëjtë dhe njohjen e të drejtave komunitetit LGBT Plus, sistemin zgjedhor, mbi hyrjen në aleanca ushtarake, mbi çështjet ekonomike, bashkësitë fetare etj.

15. Iniciativa dhe referendumi në Kosovë

Në Kosovë, nisma qytetarëve ekziston dhe kryesisht me materien legjislative. Këtë materie e normon Ligji nr. 04/L-025 për nisma legjislative ("Ligji nr. 04/L-025"). [134] Sipas nenit 3.1 (2) të **Ligjit nr. 04/L-025**, me këtë koncept nënkuptohet një propozim që ka për qëllim rregullimin e një fushe me ligj apo me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit në fuqi. Të gjitha aktivitetet për paraqitjen e nismës legjislative duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi (neni 4.1 i **Ligjit nr. 04/L-025**). Nismë legjislative, mund të marrë:

- presidenti i Republikës së Kosovës nga fushëveprimtaria e vet;
- deputetët e Kuvendit;
- qeveria; dhe, së fundi,
- më së paku dhjetëmijë (10 000) qytetarë me të drejtë vote (neni 5 i **Ligjit nr. 04/L-025**).

Neni 6 i **Ligjit nr. 04/L-025** normon refuzimin e nismës legjislative, pra kur refuzohet një nismë e subjekteve nga neni 5 i këtij ligji. Kuvendi i Republikës së Kosovës, refuzon nismën legjislative në rastet kur nisma është kundër parimeve themelore të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nuk i përmban kushtet dhe kriteret e përcaktuar me këtë ligj.

Sa i përket referendumit, ndërkaq, **KKos** e përmend atë në dispozitat e neneve për sa vijon: neni 2.1 (Dispozitat Themelore: Sovraniteti); neni 65.3 (Kompetencat e Kuvendit); 81.2 (Legjislacioni me Interes Vital); 113.2 (Gjykata Kushtetuese: Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara) dhe neni 139.1 (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve).

---

133 Oliver Nikolić, "Referendum (sa posebnim osvrtom na Švajcarsku i Hrvatsku)", fq. 19.

134 **Ligji nr. 04/L-025 për nisma legjislative**. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* /Nr. 23/26 tetor 2011, Prishtinë.

Kur definon sovranitetin, **KKos** në nenin 2.1 thotë se "Sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet, në pajtim me Kushtetutën, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, me referendum, si dhe në forma të tjera, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute". Ky nen është deklarativ dhe përshkrues, sa i përket natyrës së pushtetit në Kosovë, origjinës së tij primare. Ky nen, megjithatë, nuk është ndonjë ndihmë sa i përket përcaktimit të objektit të referendumit. I tillë nuk është as neni 65.1 i **KKos** që normon kompetencat e Kuvendit, **inter alia**, për të shpallur referendum, në pajtim me ligjin. Ky ligj sot e kësaj dite nuk ekziston (tetor 2022, koha e shkrimit të këtyre rreshtave). Pak më i qartë është neni 81.2 i **KKos** që ndalon referendumin për kategorinë e caktuara të ligjeve, përkatësisht për ligjet me interes vital që normon paragrafi i parë i nenit 81. Paragrafi i dytë i këtij neni e bënë të qartë se "asnjëri nga ligjet me interes vital, nuk mund t'i nënshtrohet referendumit". Në njëfarë mënyre ky redaktim i kësaj dispozite sikur shërben si lajmëtar i dispozitës së nenit 113.2 që i jep të drejtën gardianit të **KKos** për të vlerësuar kushtetutshmërinë e referendumit të propozuar eventual. Së fundi, dispozita e nenit 139.1 të KKos nuk bën asgjë tjetër veçse përsëritë formulimet e ngjashme që ekzistojnë edhe në vendet fqinje me Kosovën, që mandatojnë komisionet qendrore të zgjedhjeve për të përgatitur, mbikëqyrur, drejtuar dhe verifikuar të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve dhe referendumet dhe për të shpallur rezultatet e tyre. Marrë parasysh mungesën e ligjit për referendum dhe ndalesat shprehimore kushtetuese për atë se çfarë mund të jetë objekt referendumi në Kosovë, vështirë se mund të pritet që **KQZ** të realizoj këtë kompetencë të tij kushtetuese. Dispozita e nenit 139.1 të **KKos**, në fakt, më shumë është përcaktues i identitetit dhe fizionomisë së KQZ-së si një organ kushtetues, sesa një synim për mandatimin e një lloji të caktuar të kompetencës që lidhet për referendum. Sot për sot, në Kosovë nuk dihet se çfarë mund të jetë objekt referendumi dhe cila është pozita dhe roli i **KQZ-së** kundrejt një referendumi eventual.

Nismat legjislative si formë e shprehjes së vullnetit politike ndërkaq, konceptualisht janë të njëjta në të gjitha vendet përreth Kosovës. Për këtë arsye ne nuk i diskutojmë sepse për to vlejnë, **mutatis mutandis**, krejt ato që janë thënë këtu për Kosovën si dhe më sipër në këtë pjesë, kur kemi diskutuar për iniciativën si njërën ndër format e shprehjes së vullnetit të qytetarëve. Për këtë arsye, në vijim diskutojmë vetëm kategorinë kushtetuese të referendumeve në vendet fqinje. Për dallim nga Kosova, vendet përreth kanë dispozita kushtetuese shumë të qarta lidhur me referendumin, gjë që, sikur u pa, ky nuk është rasti me Kosovën.

16. Iniciativa dhe referendumi në Shqipëri

Sipas **KShq**, populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti. Referendumi është e drejtë kushtetuese dhe përfaqëson formën më të pastër të ushtrimit të demokracisë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga populli. Referendumi është parashikuar në nenet 150, 151/2, 177 dhe 108, pika 4 të **KShq**. Megjithatë, 50,000 qytetarë me të drejtë vote dhe/ose institucionet që kanë të drejtë ta propozojnë, shumë pak e kanë ndërmarrë këtë nismë direkte të demokracisë për shfuqizimin e një ligji, miratimin e një projektligji, për të vendosur për një çështje të rëndësisë së veçantë dhe për miratimin e amendamenteve kushtetuese. Deri më sot, në vendin tonë nuk janë zhvilluar referendume lokale, pavarësisht se ka pasur disa tentativa sidomos për problemin e mjedisit.

Rregullat për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen, si dhe shpalljen e rezultatit të referendumeve në vendin tonë përcaktohen në Kodin Zgjedhor të vitit 2003. Mbas këtij viti, Kodi Zgjedhor ka ndryshuar disa herë, por asnjëherë nuk janë rishikuar apo diskutuar rekomandimet mjaft të rëndësishme, që janë bërë për referendumet nga Komisioni i Venecias dhe OSBE/ODIHR, në vitin 2004. Edhe në opinionin e përbashkët të 2007, Komisioni i Venecias dhe OSBE/ODIHR evidentojnë faktin, se rekomandimet e bëra prej tyre në 2004 mbeten të pazbatuara dhe se Kodi Zgjedhor nuk ka pësuar ndryshime në këtë drejtim.

Më 29 Dhjetor 2008, Parlamenti me konsensus të gjerë miratoi Kodin e ri Zgjedhor. Në këtë Kod nuk u përfshi pjesa IX, Referendumet, por në nenin 185 të tij u theksua se: "Referendumet e ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003" të Kodit të Republikës së Shqipërisë të ndryshuar, si dhe çdo pjesë e dispozitave të tij që ka lidhje me të mbetet në fuqi, deri në miratimin e ligjit "Për referendumet e përgjithshme dhe vendore". Kjo do të thotë se duhej miratuar ligji i ri vetëm për referendumet e përgjithshme dhe ato vendore dhe jo referendumet kushtetuese, të cilat trajtohen dhe zbatohen në përputhje me nenin 177 të KShq. Prej vitit 2008 dhe deri më sot, legjislacion i zbatueshëm për referendumet janë pikërisht nenet e Kodit Zgjedhor të vitit 2003, të cilat ndër të tjerash paraqesin problem të karakterit kushtetues.

Në bazë të kuadrit si më sipër juridik, në Shqipëri janë realizuar gjithsej tri konsultime të gjera popullore, referendumet kushtetuese në vitin 1994 dhe ai në vitin 1998, si dhe referendumi për zgjedhjen e sistemit qeverisës, i mbajtur në vitin 1997.

Referendumi kushtetues i vitit 1994: Në nëntor të vitit 1994 u zhvillua i pari referendum në historinë e shtetit shqiptar, referendumi për Kushtetutën. Mazhoranca e atëhershme, e përbërë nga Partia Demokratike dhe aleatët e saj ishin pro, ndërsa opozita që kishte në përbërje Partinë Socialiste, Partinë Socialdemokrate dhe aleatët e saj ishin kundër. Në votim morën pjesë 84,30% e zgjedhësve, nga të cilët 53% votuan kundër draftit kushtetues dhe 41% pro.

Referendumi për monarkinë në vitin 1997: Më 29 qershor 1997 u zhvilluan zgjedhjet parlamentare. Partia Socialiste me aleatët u shpallën fitues, ndërsa demokratët pësuan humbjen më të thellë të historisë së tyre. Në të njëjtën ditë u zhvillua edhe referendumi për formën e qeverisjes së vendit, me alternativat "Republikë" ose "Monarki Kushtetuese" ku shumica e zgjedhësve zgjodhi formën "Republikë". Rezultati final përcaktoi se 65% e votuesve ishin pro republikës, rezultat ky i kontestuar fort nga Leka Zogu.

Referendumi kushtetues i vitit 1998: Pas rotacionit politik të vitit 1997, mazhoranca e re, Partia Socialiste dhe aleatët e saj, nisën punën për Kushtetutën e parë demokratike të Shqipërisë. Në vjeshtën e vitit 1998 drafti ishte gati dhe vendi shkoi në referendum popullor. Opozita e djathtë deklaroi abstenimin dhe mospjesëmarrjen në zgjedhje, kurse mazhoranca votoi pro draftit kushtetues. Për pasojë, Kushtetuta e Shqipërisë u miratua me referendum më 21 tetor 1998 me votat pro të 93,5 % të zgjedhësve. Ky ka qenë njëherësh referendumi i fundit që është mbajtur në Shqipëri, ku u vendos për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë si edhe për formën e qeverisjes në vend, ku u përcaktua se në Shqipëri do të kishte një sistem qeverisës të tipit Republikë Parlamentare.

17. Iniciativa dhe referendumi në Maqedoninë e Veriut

Referendumi i parë i MV ka qenë referendumi për pavarësi i datës 8 shtatorit 1991, kur vendi më pas shpalli pavarësinë nga ish-RSFJ. Miratimi i referendumit ka qenë me 96.4% të votave, me dalje të votuesve prej 75.7%. Këtë ditë në MV e festojnë si ditë të pavarësisë.

Pas këtij vjen referendumi i dytë, ai mbi autonominë e shqiptarëve, d.m.th. një referendum ku shumica etnike e një shteti voton për fatin e komunitetit tjetër etnik. Ky referendum është mbajtur më 7 nëntor 1004. Votuesit janë pyetur nëse aprovonin mohimin e planeve komunale që u jepnin më shumë autonomi shqiptarëve të këtij vendi pas lidhjes më 13 gusht të vitit 2001 të Marrëveshjes së Ohrit, më të cilën u mbyll konflikti i vitit 2001 mes shqiptarëve dhe forcave policore e ushtarake të maqedonasve etnikë. Germa dhe shpirti i Marrëveshjen kërkonin që shqiptarët të kenë më shumë autonomi komunale për rregullimin e çështjeve të arsimit, shëndetit dhe zhvillimit. Në të njëjtën kohë ka bërë reduktimin e numrit të komunave nga 123 të 84. Përkundër që 95% e votuesve thanë po reduktimit të autonomisë së shqiptarëve në sferat si më sipër, dalja në referendum ishte vetëm 27 %, nën pragun prej 50 % që kërkohet për vlefshmërinë e një referendumi. Kjo d.m.th. se ky referendum ka dështuar.

I fundit ka qenë referendumi i 30 shtatorit 2018, ku votuesit u pyetën nëse përkrahnin anëtarësimin në **BE** dhe **NATO** përmes pranimit të **Marrëveshjes së Prespës** mes **MV** dhe **Greqisë**, e nënshkruar më 12 qershor 2018, me të cilën u mbyll çështja e vjetër 27-vjeçare rreth emrit të këtij vendi. Në fakt, me Marrëveshjen e Prespës, nga emri i deriatëhershëm kushtetues Maqedoni, vendi mori emrin që ka sot, përkatësisht MV. Përkundër votimit mbi 94 %, dalja në votim ka qenë e ulët edhe këtu, më pak se 50% dolën në votim, aq sa kërkohet për vlefshmërinë e rezultatit të një referendum. Meqë ky referendum nuk ishte i detyrueshëm dhe përfshinte ndryshimet kushtetuese, atëherë duhej të ratifikohej nga dy të tretat e **Kuvendit të MV**. Kjo nënkupton se përmes Kuvendit u arrit ajo që nuk mund të bëhej përmes referendumit: më 19 tetor 2018, tetëdhjetë nga 120 deputetët e Kuvendit të MV votuan në favor të propozimit për ndryshim të emrit të vendit të tyre, pra më një rezultat të ngushtë prej dy të tretave sa kërkohet për ndryshim të **KMVe**.

18. Iniciativa dhe referendumi në Mal të Zi

Sa i përket referendumit në **Mal të Zi**, me relevancë janë, Përveç **KMZi**, edhe dy ligje që kanë rregulluar referendumin. I pari është Ligji mbi referendumin i vitit 2001 dhe i dyti Ligji mbi referendumin i vitit 2006 që ka pasur karakterin e **lex specialis** sepse ka pasur të bëjë vetëm me normimin e shpalljes së referendumit për statusin shtetëror të vendit.

Referendumi për pavarësinë e Malit të Zi ka qenë referendum për pavarësinë e Malit të Zi dhe është mbajtur më 21 maj 2006. Sipas rezultateve zyrtare, shumica e qytetarëve që kishin dalë në referendum i kishin thënë po restaurimit të pavarësisë së vendit. Nga 484,718 qytetarë me të drejtë vote, në referendum kanë dalë 419,236 (86.49%). Në favor të pavarësisë janë deklaruar 230,711 qytetarë, që kanë përfaqësuar 47,5% të krejt trupës zgjedhore, përkatësisht 55,5% në raport me krejt votat e vlefshme. Pyetja e referendumit ka qenë: "a dëshironi që Republika e Malit të Zi të jetë shtet i pavarur me subjektivitet të plotë juridik-ndërkombëtar?". Përgjigja e kërkuar ka qenë: PO ose JO. Për legjitimitet të referendumit është kërkuar dalja mbi 50% e votuesve të regjistruar, kurse për miratimin e vendimit për pavarësisë ka qenë e nevojshme që opsioni i tillë të fitoj shumicën e posaçme prej 55% të votave të vlefshme. Sipas rezultateve zyrtare, dalja në referendum ka qenë shumë e lartë, 86.49%, kurse opsioni i pavarësisë së Malit të Zi ka fituar 55,5% të votave të vlefshme, kështu që referendumi është shpallur i suksesshëm. Kuvendi i Malit të Zi më 3 qershor 2006 ka shpallur vendin shtet sovran dhe të pavarur, bazuar në rezultatet e referendumit të datës 21 maj të vitit të njëjtë.

Ky ka qenë referendumi i dytë mbi statusin shtetëror të Malit të Zi, kurse i pari referendum është mbajtur në vitin 1992 dhe ka pasur rezultat të kundërt, me 95,96% të votave për shtet të përbashkët me Serbinë, përkatësisht si njësi federale e Republikës Federale të Jugosllavisë, e themeluar në prill të vitit 1992, si shteti pestë i dalë nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë.[135]

Njëra nga çështjet kryesore ka qenë kuadri juridik malazez për zbatimin e referendumit. Kjo ka pasur lidhje me lëshimet e bëra në Mal të Zi nga udhëheqja e saj me rastin e miratimit të KMZi të vitit 1992. Pas referendumit të parë mbi statusin shtetëror, që është mbajtur më 1 mars 1992, **Mali i Zi** ka miratuar kushtetutën e re, që është miratuar më 12 tetor 1992. Në nenin 2, **KMZi** ka përcaktuar se mbi ndryshimin e statusit shtetëror, formës së qeverisjes dhe ndryshimin e kufijve nuk mund të vendoset pa referendum paraprak të qytetarëve. Kjo dispozitë, megjithatë, nuk ka përmbajtur përcaktimin për atë se çfarë shumice kërkohet për vlefshmërinë e vendimeve për çështjet si më sipër që kanë mundur të jenë objekt referendumi. E njëjta kushtetutë, në nenin 83 përcaktonte se vendimi për shpalljen e referendumit merret me shumicën e votave të krejt deputetëve të **Kuvendit të Malit të Zi**, pa definuar se cila duhet të jetë shumica e posaçme që kërkohet për miratimin e ligjit mbi referendumin dhe cili është dallimi mes referendumit të detyrueshëm për çështjet nga neni 2 i **KMZi** si më sipër dhe referendumit për çështjet tjera të vlerës më të ulët politike.

[135] Cf. më shumë për anën faktike të ngjarjeve se si janë zhvilluar në Владица Тодоровић, "РАСПАД ЗАЈЕДНИЧКЕ ДРЖАВЕ СРБИЈЕ И ЦРНЕ ГОРЕ". ПОЛИТИЧКА РЕВИЈА vol. 69 бр. 03 (2021), fq. 235-253.

Falë këtyre lëshimeve, partitë në pushtet në Mal të Zi, në vitin 2001 kanë miratuar ligjin e përgjithshëm mbi referendumin, i cili gjithashtu nuk ka bërë dallim mes të referendumeve të detyrueshme dhe referendumeve opsionale. Ligji në fjalë përcaktonte se referendumi konsiderohej i suksesshëm nëse në votim kanë dalë shumica e numrit të tërësishëm të votuesve dhe nëse pyetja e referendumit ka marrë shumicën e votave të atyre që kanë votuar.

Kjo zgjedhje ka hasur në kundërshtim të përgjithshëm të partive opozitare që kanë përqafuar qëndrimin se për vendosje legjitime për çështjet kyçe shtetërore, duhet domosdo të kërkohet vota pozitive e shumicës së krejt trupës zgjedhore, pra shumica absolute e krejt votuesve në Mal të Zi. Në debatin për këtë çështje të rëndësishme qe përfshirë edhe OSBE/ODIHR, e cila më 6 korrik 2001 ka publikuar një raport të posaçëm ku pushtetarëve të Malit të Zi u rekomandohej që për realizimin e referendumit mbi çështjet kryesore të definohet një shumicë e posaçme. Ky rekomandim i OSBE i shkonte për shtati partive opozitare të asaj kohe, me orientim proserb. Çështja fitoi peshë në vitin 2005, kur po afrohej koha e fillimit të veprimeve përgatitore për mbajtjen e referendumit të paralajmëruar mbi statusin shtetëror të Malit të Zi, i cili u diskutua më sipër. Në pranverë të këtij viti janë miratuar amandamentet në **Kartën kushtetuese të Serbisë dhe Malit të Zi** (KKSMZi), dokumenti kushtetues i nxjerrë në bazë të **Marrëveshjes së Beogradit** për formimin e **BSHSMZi**, përkatësisht për transformim të **RFJ** (Serbi-Mali i Zi) në një lidhje të lirshme shtetërore. Rëndësi të posaçme ka pasur amendamenti nr. 2 i KKSMZi, që përcaktonte se referendumi për statusin e shtetit anëtar të **BSHSMZi** do të organizohej në bashkëpunim me BE-në. Kjo paraqiste themelin e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të BE-së në procesin e referendumit, gjë që ndodhi vitin tjetër më 21 maj 2006: referendumi u organizua në bashkëpunim të plotë mes autoriteteve të Malit të Zi dhe BE e strukturave të tjera të Këshillit të Evropës.

Sa i përket iniciativës, në **Mal të Zi** ekziston iniciativa ligjore, konceptualisht e njëjtë me Kosovën dhe vendet tjera përreth. Përveç kësaj, edhe në nivel lokal mund të organizohen iniciativa të ndryshme për adresimin e problemeve të natyrë së ndryshme, të cilat këtu nuk kanë ndonjë relevancë kushtetuese për trajtim të thellësishëm.

19. Iniciativa dhe referendumi në Serbi

Në Serbi, në nivele të ndryshme është e mundur që qytetarët të nisin procedurën për nxjerrjen e ndonjë akti. Bëhet fjalë për iniciativa formale popullore, të cilat, për të prodhuar efekt juridik, duhet të mbështeten nga një numër i caktuar i qytetarëve. Bazë kryesore juridike për këtë është **KKSerb**, e cila përcakton se "sovraniteti rrjedh nga qytetarët, të cilët e ushtrojnë me referendum, iniciativë popullore dhe përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur lirisht". [136] Shtjellimet tona në vijim bazohen kryesisht në librin e autorit më me ndikim në të drejtën kushtetuese serbe aktualisht, profesorit **Ratko Markoviq**.[137]

Procedurën për amendamentim të **KKSerb** mund ta nisin së paku 150 000 votues, përmes nënshkrimit të vërtetuar në një iniciativë të tillë popullore. Nisja e kësaj iniciative nuk nënkupton vënien në lëvizje automatikisht të procedurës për amendamentim kushtetues në kuptim të nenit 203 të Kushtetutës. Kjo është kështu për shkak se kjo iniciativë duhet të mbështetet nga dy të tretat e deputetëve të Kuvendit të Serbisë dhe vetëm atëherë nis procedura për revizion kushtetues.

Shembuj të tjerë janë: iniciativa popullore me të cilën vihet në lëvizje procedura për ligjvënie, e cila duhet të mbështetet nga së paku 30 000 nënshkrime të vërtetuara të votuesve; iniciativa popullore e së paku 40 000 votues me vendbanim në **Krahinën e Vojvodinës** nisin procedurën për ndryshimin ose miratimin e aktit më të lartë -Statutit; iniciativa për ndryshimin ose miratimin e vendimit të **KKV**, për të cilën nevojiten më së paku 10,000 nënshkrime të vërtetuara të votuesve që banojnë në këtë krahinë

[136] Neni 2.1 i **KKSerb**.

[137] Ratko Marković, *Ustavno pravo i političke institucije.* Dvanaesto osavremenjeno izdanje (*Službeni glasnik: Beograd, 2008), fq. 211-220 (vetëm në alfabetin cirilik).*

autonome; iniciativa për miratimin e ndonjë akti të vetëqeverisjes lokale, për të cilën kërkohet së paku 5 % e nënshkrimeve të vërtetuara të votuesve që banojnë në atë komunë apo qytet (sipas ligjit, kjo iniciativë quhet iniciativë qytetare).

Iniciativa popullore mund të çoj deri te shpallja e referendumit. **Kuvendi i Serbisë** shpall **referendum** mbi çështjet nga kompetenca e saj, ne kërkesën e më së paku 100,000 votuesve.[138] Nëse iniciativën popullore për shpallje të referendumit krahinor e mbështetin së paku 30,000 votues në territorin e **Krahinës së Vojvodinës**, atëherë **KKV** është i detyruar të shpall referendumin. Kuvendi i komunës ose i qytetit është i detyruar të shpall referendum lokal atëherë kur iniciativën për këtë e kanë ndërmarrë së paku 10 % e numrit të tërësishëm të votuesve me banim territorin e njësisë vetëqeverisëse.

Iniciativa popullore konsiderohet si një e drejtë kolektive kurse e drejta për peticion si e drejtë individuale, e gëzon çdokush. Për dallim nga iniciativa popullore, organet shtetërore, organizatat që ushtrojnë autorizime publike, organet krahinore të Vojvodinës ose organet e vetëqeverisjes lokale, nuk kanë detyrim që të vejnë në lëvizje procedurën sipas iniciativës popullore dhe të nxjerrin aktin e kërkuar. Detyrim i tyre i vetëm është që parashtruesit t'i përgjigjen në iniciativën e parashtruar, nëse një gjë e tillë është kërkuar, kurse procedimi sipas saj është në duart e vetë organeve dhe organizatave si më sipër.

Forma e ushtrimit të drejtpërdrejtë të pushtetit në njësinë e vetëqeverisjes lokale është tubimi qytetarëve. Kërkesat dhe propozimet e miratuara në tubim të qytetarëve iu dërgohen organeve të vetëqeverisjes lokale. Këto kanë detyrim që të njëjtat t'i shqyrtojnë dhe të marrin qëndrim, për të cilin njoftojnë qytetarët.

Në Serbi ekzistojnë referendumet republikane, krahinore (me kuptim Vojvodinën) dhe lokale, në të cilat vendoset me shumicën e votave të votuesve që kanë dalë në zgjedhje, por që për vlefshmërinë referendumit lokal është e nevojshme të dalin në zgjedhje shumica e votuesve të regjistruar. Në referendum nacional hyjnë referendumet për çështje kushtetuese dhe referendumet për çështjet nga kompetenca e **Kuvendit të Serbisë**. Të dyja i shpall **Kuvendi i Serbisë**. Referendumi kushtetues shpallet për amendamentimin e kushtetutës ekzistuese ose për nxjerrjen e kushtetutës së re. Në ndërkohë që në rastin e parë ai është çdo herë i detyrueshëm, në rastin e dytë vetëm nëse bëhet fjalë për pjesët e përmendura një nga një të **KKSerb**.[139] Për të gjitha rastet tjera, referendumi kushtetues është fakultativ (mund të organizohet por nuk është e domosdoshme). Referendumi kushtetues është i mëpastajmë, i detyrueshëm dhe mund të jetë konstituiv dhe abrogativ, në vartësi të asaj se cili është vendimi i marrë në referendum.

Kuvendi i Serbisë, me propozim të së paku 100,000 votuesve apo shumicës së deputetëve, mund të shpallë referendum për çdo çështje që bien në kompetencë të tij. Në KKSerb është thënë se referendumi nuk mund të shpallet kur bëhet fjalë për detyrimet shtetërore nga marrëveshjet ndërkombëtare, ligjin për të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, ligjet tatimore dhe ligjet tjera financiare, ligjin mbi buxhetin dhe llogarinë përfundimtare, ligjin mbi amnistinë, vendimin për vënien e gjendjes së jashtëzakonshme, si dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me kompetencat zgjedhore të Kuvendit.[140] **KKSerb**, në mënyrë të posaçme ka përcaktuar shpalljen e referendumit për ndryshim të kufijve shtetëror,[141]për miratimin e ligjit të posaçëm për autonominë substanciale të Kosovës, të cilën ata e ëndërrojnë si territor serb dhe si pjesë integrale të shtetit serb, si dhe ligjit për themelimin dhe abrogimin e krahinave autonome.[142] Sikundër shihet, këtu bëhet fjalë për statusin kushtetues të Kosovës, të cilën Republika e Serbisë e konsideron si pjesë të autonomive territoriale, diçka

138 Neni 108 i **KKSerb**.
139 Neni 203 i **KKSerb**.
140 Neni 108 i **KKSerb**.
141 Neni 108 i **KKSerb**.
142 Neni 182 i **KKSerb**.

që është krejtësisht jashtë realitetit jetësor, vendimit të **Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë** (GJND) të datës 22 korrik 2010, me të cilin është afirmuar se **Deklarata e datës 17 shkurt 2008**, me të cilën Kosova është shpallur shtet sovran dhe i pavarur, nuk ka shkelur asnjë normë të së drejtës ndërkombëtare. Për rrjedhojë, këto dispozita kushtetuese serbe nuk përbëjnë asgjë tjetër pos ndërhyrje në punët e brendshme të një shteti sovran dhe të pavarur që quhet Republikë e Kosovës. Këso pretendimesh territoriale kanë pasur edhe disa prej shteteve të reja të dala nga ish-Jugosllavia, por kanë qenë të detyruara të heqin nga kushtetutat e tyre kur kanë kërkuar anëtarësim në strukturat euroatlantike politike dhe ushtarake. Shpresojmë që serbët të kuptojnë një ditë dhe ta heqin nga kushtetuta referimin absurd mbi Kosovën si autonomi substanciale dhe pjesë e Serbisë. Kjo bëhet edhe më absurd kur merret parasysh fakti se këto referendume që prekin Kosovën janë të detyrueshme, të mëpastajme dhe, në vartësi të rezultatit, mund të jenë konstituive ose abrogative.

Njëjtë me Kuvendin e Serbisë, edhe **KKV-ja** mund të vendos që disa çështje nga kompetencat e saj, të vendosen me referendum krahinor, nga ana e qytetarëve me banim në Vojvodinë. Vendimin e shpallur në referendumin krahinor e shpallë **KKV-ja**.

Referendumin lokal e shpall kuvendi i njësisë vetëqeverisëse lidhur me çështjet nga kompetenca e saj. Vendimi në referendum konsiderohet i miratuar nëse për të kanë votuar më shumë se gjysma e atyre që kanë dalë në zgjedhje me vendbanim në territorin e njësisë vetëqeverisëse, me kusht që në referendum kanë votuar shumica e numrit të tërësishëm të votuesve të regjistruar. Referendumi është i detyrueshëm dhe vendimi i marrë në të nuk mund të ndryshohet për një vit në vijim.

20. Partitë politike

Partitë politike janë element i domosdoshëm dhe vlerë kryesore e shtetit demokratik. Në disa vende ato janë kategori kushtetuese, janë të konstitucionalizuara, praktikë kjo e nisur me **Kushtetutën e Vajmarit** (1919). Në të tjerat ato normohen vetëm me ligj. Në dy rastet ato paraqesin një element të rëndësishëm të së drejtës kushtetuese të vendeve demokratike dhe janë të pandashme nga sistemi i demokracisë përfaqësuese, në të cilën populli zgjedh përfaqësuesit e vet që në emër të tij të ushtrojnë pushtetin politik.[143] Përfaqësuesit e tillë të popullit janë, në pjesën dërrmuese, anëtarë të partive politike, e shumë më rrallë anëtarë të organizatave të tjera politike (shoqata, lëvizje, grupe) apo personalitete jashtë partiake. Shteti i pranon partitë politike, i regjistron, kurse mbikëqyrja ndaj tyre konsiston në kontrollimin e burimeve të tyre financiare, shpenzimit të ligjshëm të mjeteve dhe të veprimit në pajtim me kushtetutën dhe ligjin.
Një kontroll i posaçëm është ai i qëllimeve politike të partive politike, pajtueshmëria e tyre me parimet kushtetuese dhe rendin demokratik, si dhe aktivitetet që ndërmerren për realizimin e atyre qëllimeve. Nëse qëllimet dhe aktivitetet e partive politike rrezikojnë seriozisht rendin kushtetues, sigurinë, liritë dhe të drejtat njerëzore dhe vlera të tjera, puna e tyre mund të ndalohet me vendim të gjykatës kushtetuese apo organit tjetër shtetëror.

Konsiderohet se pararendësit e organizimit të sotëm politik janë partia konservative **Tory** ("Tories"), si oborrtarë të kurorës dhe partia liberale **Uigët** ("Whigs"), që sot quhet Partia Laburiste, që ka luftuar politikisht për supremacinë e parlamentit dhe dobësimin e kurorës nga fundi i shek. XVII deri në fillim të shek. XIX. E thënë me fjalë të tjera, në fund të shek. XVII, konkretisht pas **Revolucionit të Madhërishëm** të vitit 1688, kanë lindur partitë politike si më sipër, njëra që ka mbrojtur absolutizmin e kurorës britanike, kurse tjetra që ka synuar kufizimin e absolutizmit mbretëror britanik. Në **Francën** revolucionare në fund të shek XVIII vjen deri te ndarja në të majtën dhe të djathtën politike, përkatësisht deri te organizimi politik si vijon: zhirondinët – republikanë të

[143] Cf. më shumë për statusin juridik të partive politike në aspektin historik, krahasimor dhe aktual në Francis Hamon, "Le statut des partis politiques". Në Dominique Chagnollaud, Michel Troper, *Traité international de droit constitutionnel. Distribution des pouvoirs. Tome 2* (Traités Dalloz: Paris, 2012), fq. 413-440.

moderuar; jakobinët – republikanët radikal; burbonët - monarkistët, bonopartistët dhe orleanistët. Në kohën pas pavarësimit të **SHBA**-ve, politikisht organizohen federalistët, konfederalistët, republikanët, demokratët, antimasonët.

Përkundër që janë prezentë gjithandej në jetën e shteteve bashkëkohore, në literaturë është vërejtur se nuk ekziston një definicion rreth të cilit pajtohen politologët, aq më pak konstitucionalistët. Në një definim të shpejtë e të lirë, mund të thuhet se partia politike definohet si një organizatë politike e njerëzve të mbledhur rreth një ideologjie që vepron politikisht me qëllim të marrjes së pushtetit. Ky definicion nuk duket i plotë. Mbase edhe në duhet të pajtohemi me konstitucionalistin e mirënjohur **Francis Hamon**, që për definimin e partive politike më së miri është të mbështetemi te definimi që ka bërë **Komisioni i Venecias (KV)**: një parti politike është një asociacion që karakterizohet me një përhershmëri, që për qëllim kryesor ka prezantimin e kandidatëve në zgjedhje për të qenë e përfaqësuar brenda institucioneve politike dhe për të ushtruar pushtetin në të gjitha nivelet, nacionale, regjionale dhe lokale, apo në ndonjërin prej tyre.[144] Partitë politike kanë një organizim të brendshëm, që përbëhet nga organet partiake (kuvendet, seksionet, këshillat, komisionet etj.) dhe anëtarësia, të cilat normohen me akte partiake (statut, rregullore dhe akte të tjera). Partia politike është e organizuar në mënyrë hierarkike, me liderin apo udhëheqësin e partisë në krye të saj (kryetar/president, shef, sekretar i përgjithshëm etj.) dhe më rrallë një organ kolektiv (komitet i partisë). Pas liderit vijnë funksionarët e partisë e në fund janë anëtarët e saj. Partitë politike në mënyrë periodike zgjedhin funksionarët e vet, kurse në partitë lideriste, që kanë udhëheqës të dalluar dhe me ndikim, i njëjti funksionar rrinë në krye të partisë për një kohë të gjatë.

Ideologjia partiake është një tërësi e ideve politike dhe pikëpamjeve mbi botën, të cilat janë të përbashkëta për anëtarët e partisë. Ato, në të vërtetë janë parime partiake, si*ç* e thotë **Edmond Burke** (Edmund Burke: 1729-1797), rreth të cilave të gjithë janë të një mendimi.[145] Rëndësinë e ideologjisë partiake, megjithatë, nuk duhet idealizuar sepse mjaft shpesh ajo nuk është unike edhe nuk e ndajnë krejt anëtarët e partisë, por as nuk është arsye vendimtare për hyrje në një parti politike. Në partitë e mëdha, sipas rregullit, ekzistojnë përçarje të brendshme që mund të çojnë në krijimin e fraksioneve brendapartiake.

Aktiviteti politik i partisë përfshin aktivitetet gjatë fushatës zgjedhore dhe në kohës paszgjedhore. Gjatë fushatës zgjedhore partitë politike ndërmarrin aktivitete me qëllim të prezantimit të ideologjisë dhe programit politik zgjedhësve: organizojnë mitingje, tribuna, tubime, prononcohen për media dhe kështu me radhë. Pas zgjedhjeve, nëse fitojnë, partitë politike formojnë organet e pushtetit: qeverinë, organet e administratës, organet e vetëqeverisjes lokale (vendore), dhe kështu marrin pushtetin. Partia politike fiton pushtetin vet ose në koalicion me partitë tjera, në të cilin rast pjesërisht, në pajtim më marrëveshjen ndërpartiake, merr pjesë në ushtrimin e funksioneve të pushtetit. Me humbjen në zgjedhje, partia politike bëhet opozitë dhe aktiviteti i saj konsiston në kontrollin dhe kritikën e pushtetit dhe përgatitjen për zgjedhjet tjera.

Roli i partive politike në shtetet bashkëkohore është i shumëfishtë. Ato vërtetojnë dhe kanalizojnë vullnetin politik të individëve që kanë pikëpamje e mendime të ndryshme. Në vend të shoqërisë me grupe të vogla, ato krijojnë shoqërinë me disa parti të mëdha dhe të organizuara që mund të udhëheqin shtetin. Ky grupim nuk guxon të përcillet me ndarje e përçarje të popullit në grupime armiqësore politike. Në shumë vende me kushtetutë parashikohet mundësia e shpërndarjes së partive politike që kërcënojnë demokracinë, ekzistencën e shtetit apo parimet themelore të regjimit. Kështu, ta zëmë, nisur nga përvoja e hidhur gjermane me **Fuhrerprinzip** të regjimit nazist (parimi i liderit suprem që qëndron mbi kushtetutën dhe ligjin, vullneti tij shërben si parametër për vlerësimin e vullnetit të popullit) të regjimit nazist,

144 Francis Hamon, "Le statut des partis politiques", fq. 414.

145 Anson D. Morse, "What is a Party?" *Political Science Quarterly* Vol. 11 No. 1 (March 1896), fq. 68-81, në fq. 75-76.

neni 21 i Ligjit Themelor (LTH) saktëson që organizimi i brendshëm i partive politike duhet të jetë konform parimeve demokratike; edhe neni 4 i Kushtetutës së Francës (**KFr**), megjithatë që është më pak i saktë, përcakton që partitë politike duhet të respektojnë parimet e demokracisë. Një rol të madh në këtë drejtim kanë luajtur gjykatat kushtetuese, të cilat kanë shërbyer si gardiane të demokracisë kushtetuese, duke ndaluar partitë politike të proveniencës së caktuar, që me veprimet e tyre kanë rrezikuar rendet kushtetuese dhe parimet fundamentale të demokracisë. Të tilla janë rastet në Gjermani: në vitin 1952 është ndaluar veprimtaria e partisë neonaziste, kurse në vitin 1956 aktiviteti i partisë komuniste. Roli i gjykatës kushtetuese si gardian i demokracisë kushtetuese nuk kufizohet vetëm në këto dy vende, por edhe në shtetet tjera anëtare të **KE**: në Spanjë, partia separatiste e regjionit të **Baskisë**, **Batasuna**, është shpërnda në vitin 2005, për shkak të lidhjeve të supozuara të saj me lëvizjet terroriste; në Turqi janë ndaluar dhe shpërndarë njëzetë e katër parti që nga viti 1962 etj. Pushteti i shpërndarjes duhet të ushtrohet në bazë të kushteve saktësisht të përcaktuara me kushtetutë. Edhe **KV** ka kërkuar që, formalisht, për fatin e partive politike që bien ndesh me kushtetutën të vendos organi me autorizime juridiksionale, jo organi administrativ. Kjo nuk do të thotë domosdo që organi juridiksional të ketë formën e gjykatës kushtetuese: ai mund të jetë edhe gjyqësori i rregull, siç është rasti me Spanjën, ku për fatin e partive politike që bëjnë aktivitet dhe kanë qëllime anti-kushtetuese vendos gjyqësori i rregullt, kurse me amparo (ankesë kushtetuese) mund të kontestohet vendimi i këtij gjyqësori në **Gjykatën Kushtetuese të Spanjës** (GJK-Sp). Nga ky rregull, Franca bën përjashtim: në këtë vend, vendimin mbi fatin e partisë politike e merr Presidenti republikës, bazuar në një ligj të vitit 1936, kurse vendimi eventual për shpërndarje mund të sfidohet vetëm sa i përket legalitetit në gjyqin suprem administrativ francez – **Këshilli i Shtetit** (“*Conseil d’État”*). Sa i përket kushteve përmbajtësore apo joformale që duhet të plotësohen për të shpërndarë një parti politike, bazuar në përvojën e vendeve të ndryshme evropiane, ato zakonisht kanë të bëjnë ose me **metodat e përdorura** (për arritjen e qëllimeve politike) ose me vetë **qëllimet politike** që ndjek (synon) partia caktuar. Sa i përket metodave, ato kanë të bëjnë në rend të parë me përdorimin e dhunës si mjet për arritjen e qëllimeve politike. Ky standard në Francë është sanksionuar qysh me ligjin e sipërpërmendur të vitit 1936, që ndalon partitë politike që kanë forma organizative të grupeve luftarake ose milicive private, ani pse mund të mos kenë ndërmarrë asnjë veprim të dhunshëm. Ky standard është zbatuar në rastin spanjoll të ndalimit të partisë **Batasuna**. Sa i përket qëllimeve politike si shkak për ndalimin dhe shpërndarjen e partive politike, ato duhen kërkuar në programet e partive politike dhe pozicionin që ato kanë lidhur me natyrën e shtetit, organizimin e tij politik, ekonomik dhe social.[146]

Ekzistimi i partive politike mundëson zgjidhje politike, zgjidhje në mes të dy alternativave. Me ekzistimin e shumë partive politike, së paku dy sosh, ofrohet zgjidhje mes kandidatëve të ndryshëm dhe opsioneve politike. Kandidatët e zgjedhur qëndrojnë nën regjimin partiak: partitë politike disiplinojnë deputetët dhe ministrat, por edhe i mbrojnë nga presionet e jashtme të grupeve të interesit (lobet) dhe individët e ndryshëm me fuqi në shoqëri. Një rol të rëndësishëm partitë politike e luajnë në edukimin dhe arsimimin e votuesve për mbrojtjen e interesit të përgjithshëm, mbrojtjen e të mirave publike dhe tejkalimin e preokupimeve individuale. Ato njoftojnë votuesit mbi ndodhitë shoqërore, sqarojnë dukuritë shoqërore dhe qëllimet e ndryshme politike.

Sistemin partiak e përbëjnë më shumë parti (deri në qindra sosh). Në sistemin shumëpartiak, zakonisht ekzistojnë disa parti që mund të marrin pushtetin, kurse të tjerat, në të vërtetë shumica prej tyre, nuk janë politikisht të rëndësishme. Formë e veçantë e sistemit shumëpartiak është **sistemi dypartiak**, në të cilin partitë e mëdha politike ndërrohen në pushtet (Britania e Madhe, SHBA), duke formuar kësisoj qeverinë (ekzekutivin) njëpartiak. Edhe në sistemin dypartiak ekzistojnë më shumë parti, por dy janë dominante falë, para së gjithash, **sistemit mazhoritar zgjedhor**. I kundërt me sistemin shumëpartiak është sistemi njëpartiak (Kina, Kuba, ish-vendet komuniste në Evropën juglindore dhe qendrore), në të cilin ekziston një parti politike shtetërore që çdo herë është në pushtet. Këtu praktikisht nuk ekziston liria e organizimit politik dhe as sistem partiak, sepse ekziston vetëm një parti që as nuk lejon të votohet për ide të tjera

[146] Cf. më shumë në Francis Hamon, “Le statut des partis politiques”, fq. 433-435.

politike. Këtë pozitë, sistemi njëpartiak zakonisht e ka të garantuar me kushtetutë. Sipas numrit dhe rëndësisë që kanë partitë, sistemet partiake quhen me emra të ndryshëm: sisteme të polarizuara, integrale, me partinë dominante, pastaj, sisteme partiake me opozitë dhe sisteme partiake pa opozitë.[147]

Partitë politike mund të grupohen sipas kritereve të ndryshme dhe kjo studiohet në shkencat politike. Sipas kriterit ideologjik, partitë politike, sipas rregullit, klasifikohen në: të djathta, të majta dhe të qendrës. Partitë e djathta janë: konservatore, klerikale, populliste, radikale. Partitë e ekstremit të djathtë janë: neofashiste, neonaziste, raciste dhe militariste. Në partitë e majta konsiderohen partitë: komuniste, socialiste, social-demokratike, të gjelbra (ekologjike). Si parti të ekstremit të majtë konsiderohen partitë: revolucionare, anarkike, maoiste. Në qendër të spektrit ideologjik janë partitë që kombinojnë dhe zbusin idetë e të majtës dhe të djathtës, prandaj edhe quhet e djathta e moderuar dhe e majta e moderuar. Ideologjia e partisë së qendrës në thelb është ideologjia e partive liberale, e cila qëndron mes të socialdemokracisë dhe liberalizmit.

Partitë politike kanë rëndësinë më të madhe në funksionimin e institucioneve politike, para së gjithash qeverisë (ekzekutivit) dhe parlamentit. Pa to nuk mund të shikohen siç duhet marrëdhëniet politike dhe ato kushtetuese në sistemet e pushtetit. Nëse marrim, ta zëmë, sistemin parlamentar, në të drejtën kushtetuese thuhet se aty, në bazë të sistemit të ndarjes së pushtetit, ekziston një marrëdhënie e baraspeshës dhe kontrollit mes qeverisë (ekzekutivit) dhe parlamentit, ku dy anët kanë të drejta që ndikojnë në tjetrën anë – e drejta e zgjedhjes, e drejta e shpërndarjes, e drejta e kontrollit. Në thelb, megjithatë, baraspesha mes qeverisë (ekzekutivit) dhe parlamentit gjendet nën hijen e marrëdhënieve të pushtetit dhe opozitës, përkatësisht mes partive politike në pushtet dhe atyre në opozitë. Marrëdhënia mes pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ realisht varet nga ajo nëse partia e njëjtë politike, apo koalicioni i partive, formon qeverinë dhe ka shumicën e deputetëve në parlament. Në rrethana normale dhe stabile të funksionimit të parlamentarizmit, kur qeveria dhe shumica parlamentare burojnë nga partia e njëjtë politike ose koalicioni i partive, pushteti ekzekutiv dhe ligjvënës punojnë së bashku. Nga kontrolli dhe baraspeshimi i pushtetit ngelet vetëm veprimtaria politike e pakicës parlamentare nga partitë politike opozitare, e cila ka mundësi të kufizuara të kontrollit dhe frenimit të pushtetit ekzekutiv, pa mundësinë e ndërrimit të saj para zgjedhjeve të reja.

Rëndësia e partive politike në veçanti rritet në sistemet proporcionale zgjedhore, në të cilat, siç u pa, votuesit votojnë për partinë politike, jo për vetë kandidatët. Kjo krijon paradoksin e përfaqësimit modern: përfaqësuesit e popullit apo kombit nuk janë përgjegjës para atyre që i kanë zgjedhur, por para partive të veta.[148] Deputetët e tillë praktikisht nuk kanë legjitimitet dhe shërbejnë si një makinë votimi e lidershipit të partisë, sipas rregullit të vjetër të "ligjit të egër të oligarkisë", të cilit i përmbahen partitë politike. Teoria politike e "ligjit të egër të oligarkisë" për herë të parë u zhvillua nga sociologu italian me origjinë gjermane **Robert Mishels** (Robert Michels: 1876-1936) në librin e tij *Political Parties* (1911). Në këtë libër, autori konstaton se një elitë, apo oligarki, është e pashmangshme në çdo organizatë demokratike dhe përbën pjesë të domosdove taktike dhe teknike të organizatës. Të gjitha organizatat e mëdha, pa marrë parasysh sa demokratike janë, kur nisin punën, shndërrohen në oligarki, për shkak se asnjë organizatë e madhe dhe komplekse nuk mund të funksionojë si demokraci e pastër. Për pasojë, pushteti brenda saj, çdo herë delegohet të individët brenda grupit, të zgjedhur ose jo. Kjo bën që të gjitha organizatat, herët a vonë, të udhëhiqen nga lidershipi klasor dhe ideologjik, që funksionon si administrator me pagesë, ekzekutiv, zëdhënës apo strategjist politik për organizatën. Larg të qenit shërbëtor të masave, **Mishels** argumenton se ky lidership, jo anëtarësia e organizatës, pashmangshmërisht rritet dhe dominon strukturat e saj e të pushtetit të organizatës. Për këtë arsye, qëllimi primar i hapur i demokracisë përfaqësuese për eliminim të

147 Cf. më shumë në Jerzy J. Wiatr, "Political Parties, Interest Representation and Economic Development in Poland". *The American Political Science Review* Vol. 64, No. 4 (Dec., 1970), fq. 1239-1245; Luciano Bardi and Peter Mair, "The Parameters of Party Systems" *Party Politics* Vol. 14 Issue 2 (2008), fq. 147-166.

148 Pierre Brunet, "La representation". Në Michel Troper, Dominique Chagnollaud, *Traité international de droit constitutionnel. Théorie de la Constitution*. *Tome 1* (Traités Dalloz: Paris, 2012), fq. 608-641, në fq. 625-631.

sundimit të elitës është i pamundur: demokracia përfaqësuese është fasadë që legjitimon sundimin e elitës së caktuar dhe se ky sundim i elitës, të cilën **Mishels** e quan oligarki, është i pashmangshëm.[149] Studimi i tij nuk kishte të bënte vetëm me partitë e tradicionale konservative të kohës së tij. Që në vitin e largët 1911, ai ka argumentuar se, në mënyrë paradoksale, partitë socialiste të Evropës, përkundër ideologjisë së tyre demokratike dhe përcaktimeve për pjesëmarrje të masave, po dominoheshin nga liderët e tyre njëjtë sikur partitë tradicionale konservative të kohës. Konkluzioni i tij, mjaft aktual edhe sot, ishte se problemi sundimit të oligarkisë qëndron në vetë natyrën e organizatave të mëdha dhe komplekse. Koha në të cilën kishte jetuar **Robert Mishels** kishte dëshmuar se sa më liberale e demokratike shoqëria, më fuqishëm lejohej formimi i organizatave me qëllime inovative dhe revolucionare, të cilat sa më komplekse e më të mëdha që ishin, më pak demokratike e revolucionare ngeleshin në përmbajtje. **Mishels** e formuloi ligjin e hekurt të oligarkisë në shprehjen famoze: "Kush përmend organizatën, ka parasysh oligarkinë".[150] Debati për këtë ka qenë aktual përgjatë shekullit të kaluar, ngelet i tillë sot e kësaj dite: partitë politike veprojnë kryesisht sipas disiplinës së brendshme që dikton lidershipi i disa personave në krye të tyre.[151]

Ky rrezik i oligarkizmit të partive politike ka qenë i vërejtur edhe nga të tjerët, si p.sh. **Moisei Ostrogorski** (Moisey Yakovlevich Ostrogorsky: 1854-1921), i cili që para **Luftë së Parë Botërore** kishte propozuar zëvendësimin e partive permanente, të ngurta e disiplinuara, me grupacione të përkohshme që do të formoheshin dhe riformoheshin lirshëm sipas problemeve që lindin në momente të caktuara, si përgjigje ndaj problemeve të tilla. U mor vesh, kjo përbën një utopi dhe demokracitë përfaqësuese duhet të pajtohen me faktin se partitë politike janë ndërmjetësi mes popullit sovran dhe qeverisësve dhe transmetuesi më i fuqishëm i vullnetit të përgjithshëm, pa të cilat, siç e ka thënë **Hans Kelsen** (Hans Kelsen: 1881-1973) demokracia do të ishte një hipokrizi dhe iluzion. Demokracia nuk është e mundur pa parti politike. Ato kanë lindur shumë kohë para se të lindin kushtetutat e para të shkruara.[152] Kjo shpjegon arsyen pse ato nuk varen nga sanksionimi kushtetues: mjafton të ekzistojë, juridikisht dhe faktikisht, liria e asociimit të qytetarëve. Në Francë, ta zëmë, ato u shfaqen në gjysmën e parë të shek. XIX, shumë më vonë se në Angli - në vitin 1688, mirëpo formalisht u sanksionuan vetëm me Kushtetutën e vitit 1958.

21. Komente dhe pyetje

21.1. Çfarë ka thënë Abraham Linkoln për votën dhe plumbin?
21.2. Sidoqoftë, për shkak të përhapjes së tyre të madhe, vendet demokratike mund të bazohen në demokraci të drejtpërdrejtë, gjysmë të drejtpërdrejtë dhe përfaqësuese. Diskutoni!
21.3. Çka ka qenë **eklezia** në Greqinë e vjetër**?**
21.4. As ardhmëria e demokracisë së drejtpërdrejtë, në të cilën të gjithë qytetarët vendosin, nuk duket të jetë e ndritur. Për më tepër, mund të thuhet se rikthimi i demokracisë së drejtpërdrejtë si mënyrë e marrjes së vendimeve publike përbën një utopi në vete. Pse?
21.5. Lidhur me zgjedhjet duhet të dallohen konceptet themelore, siç janë: **e drejta zgjedhore**; **e drejta e zgjedhjes**; dhe **e drejta e votës**. Diskutoni!
21.6. Çka është e drejta zgjedhore dhe çka e dallon atë nga e drejta e zgjedhjes dhe e drejta e votës?
21.7. Burimet e brendshme të së drejtës zgjedhore përpunojnë dispozitat e marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, me fillim nga kushtetuta e deri te aktet nënligjore. Kushtetutat përmbajnë normat më të rëndësishme të së drejtës zgjedhore. Me çfarë kanë të bëjnë kryesisht këto norma kushtetuese në sferën e të drejtës zgjedhore?
21.8. Cilat norma kushtetuese të së drejtës zgjedhore përpunohen më tej me ligjet mbi zgjedhjet?

---

149 Cf. James L. Hyland. *Democratic theory: the philosophical foundations*. (Manchester University Press: Manchester, 1995), fq. 247.
150 Darcy K. Leach, "The Iron Law of What Again? Conceptualizing Oligarchy Across Organizational Forms", *Sociological Theory*, Vol. 23, No. 3 (September 2005), fq. 312-337 në fq. 312, 320.
151 Ibid., fq. 312, 320.
152 Francis Hamon, "Le statut des partis politiques", fq. 415.

21.9. Me **akte nënligjore** normohen aspektet procedurale dhe teknike të realizimit të zgjedhjeve, gjithashtu të domosdoshme për zbatimin e ligjshëm të zgjedhjeve të lira e të drejta. Kush bën pjesë në këtë grup të akteve?
21.10. Normativa apo rregullat zgjedhore mund të grupohen edhe në aspektin e përmbajtjes, përkatësisht sipas objektit që rregullojnë. Në këtë kuptim ekzistojnë **rregullat e të drejtës zgjedhore materiale** dhe **rregullat e të drejtës zgjedhore procedurale**. Çka normojnë njëri grup i rregullave e çka tjetri?
21.11. Çka është **gjeometria (gjeografia) zgjedhore**?
21.12. Kufijtë e njësive zgjedhore, me ndryshim ose mosndryshim për një kohë të gjatë, mund të shndërrohen në mjet favorizimi të kandidatëve të caktuar. Si quhet ky mjet favorizimi në të drejtën zgjedhore?
21.13. Çka është **matematike zgjedhore**?
21.14. Çka normohet me rregullat e **teknikës zgjedhore**?
21.15. Çka përfshin e drejta e zgjedhjes, cilët komponentë?
21.16. Lidhur me **natyrën juridike** të së drejtës së zgjedhjes ekzistojnë pikëpamje të ndryshme. Ato mund të grupohen në tri grupe. Cilat janë ato?
21.17. Cilat janë kushtet për fitimin e të drejtës aktive zgjedhore dhe cilat janë cilësitë e saj?
21.18. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi mund të kenë zotësinë e kufizuar të zgjedhjes. Me cilin lloj të zgjedhjeve ka të bëj kjo?
21.19. Cilësia e të qenit një **e drejtë e përgjithshme** paraqet një karakteristikë të kohës së re, të cilën e drejta e zgjedhjes nuk e ka pasur në të gjitha kohërat. Në kohën e kushtetutave të para, diku deri kah mesi i shek. XX, **e drejta e zgjedhjes nuk ka qenë e përgjithshme**. Grupe të tëra shoqërore të moshës madhore dhe me zotësi të plotë veprimi **kanë qenë të përjashtuara nga gëzimi i kësaj të drejte**. Pse?
21.20. Cili faktor ka shërbyer më së gjati si pengesë për realizimin e të drejtës së zgjedhjes?
21.21. Ekziston një sistem i **votës plurale**, ndryshe i njohur edhe si **epistokraci**. Çka do të thotë kjo?
21.22. Çka është **votimi familjar** dhe çfarë dallon nga votimi që ndikohet nga anëtarët e familjes reciprokisht?
21.23. Kur ekziston pabarazia në realizimin e të drejtës aktive të zgjedhjes për shkaqe faktike?
21.24. A është e drejta pasive e zgjedhjes një e drejtë e ndërgjyqshme?
21.25. Në kushte të rrepta, në raport me të drejtën aktive të zgjedhjes, përmendet **mosha** e individëve që dëshirojnë të realizojnë të drejtën pasive të zgjedhjes. Ajo mund të jetë e ndryshme për kandidatët për dhomën e lartë dhe dhomën e ulët të parlamentit s i dhe për pretendent për kryetar republike (shef shteti). Çfarë do të thotë kjo? Tregoni me shembuj konkret sipas zgjedhjeve kushtetuese të disa vendeve perëndimore.
21.26. Përveç këtyre kushteve formale, para të drejtës pasive të zgjedhjes dhe kandidatit paraqitet edhe një kusht përmbajtësor. Ai është **anëtarësia në parti politike** ose **përkrahja partiake kandidaturës së kandidatëve në zgjedhje**. A bëhet fjalë këtu për një kusht juridiko-kushtetues?
21.27. E drejta pasive e zgjedhjes realizohet me **kandidim**. Kandidimi mund të jetë individual (uninominal) dhe me lista zgjedhore (plurinominal). Çka është njëri e çka tjetri?
21.28. Çka nënkuptohet me cilësinë e zgjedhjeve të drejtpërdrejta ?
21.29. Çka nënkuptohet me **votën e bartshme individuale**?
21.30. Çka nënkuptohet me **votën preferenciale**?
21.31. Çka është vota e a.q. **panachange** dhe në cilat shtete përdoret?
21.32. Për të zvogëluar hendekun që mund të krijohet në mes të votuesit dhe kandidatëve, ekzistojnë lista të ndryshme zgjedhore në të cilat zgjedhësit mund të deklarohen edhe vetëm për kandidatin, pra jo vetëm për listën zgjedhore si tërësi. Cilat janë këto lloje?
21.33. **Të drejtën për shpallje të zgjedhjeve** e kanë organet e autorizuara me kushtetutë ose ligj. Diskutoni!
21.34. Çka është njësia zgjedhore dhe kush e përbën atë?
21.35. Kur ekziston vetëm një njësi zgjedhore, atëherë ajo ka disa përparësi matematikore, më saktë-

sisht këtu vjen deri të reflektimi më besnik i mandateve të fituara në parlament në proporcion me votat e marra. Cila është e meta kryesore e saj?

21.36. Ekzistojnë dy lloje të njësive zgjedhore. Diskutoni!

21.37. Cilat janë kriteret tjera merren parasysh me rastin e formimit të njësive zgjedhore ?

21.38. Çka është **xherimandering**-u? A mund të aplikohet në shtetet me një njësi zgjedhore?

21.39. Pas konstatimit të rezultateve të zgjedhje, pason shpërndarja e mandateve apo konvertimi i votave në mandate, të cilat më pas shpërndahen sipas procedurës së përcaktuar ligjore dhe duke u bazuar në autorizimin kushtetues përkatës. Shpërndarja e mandateve reflekton vullnetin politik të votuesve. Për këtë arsye kjo përbën njërën ndër aspektet më të rëndësishme të **sistemit zgjedhor** dhe **demokracisë përfaqësuese** në përgjithësi. Cilat janë ato sisteme zgjedhore?

21.40. Cilat janë cilësitë e sistemit mazhoritar dhe cilat të atij proporcional?

21.41. A është sistemi proporcional i zbatueshëm në zgjedhjet e drejtpërdrejta të **shefit të shtetit** apo **liderëve** të vetëqeverisjes lokale (vendore)?

21.42. Pse caktohet **pragu zgjedhor**? A ekziston ai në sistemin mazhoritar?

21.43. Nga pragu zgjedhor duhet dalluar **pragun natyror zgjedhor**: numri i votave, i shprehur në përqindje, që është i domosdoshëm për marrje apo fitim të një mandati (sikur mos të ekzistonte pragu zgjedhor). Si fitohet pragu natyror zgjedhor?

21.44. Në **sistemin e përzier zgjedhor** një numër i deputetëve zgjidhet individualisht, me sistemin mazhoritar, kurse pjesa tjetër e tyre zgjidhen në lista zgjedhore, me sistemin zgjedhor proporcional. Pse bëhet kjo? Si zbatohet?

21.45. Në sistemet proporcionale, votat e hedhura shndërrohen në mandate përmes operacioneve matematikore. Diskutoni!

21.46. **Metoda Saint-Lague**, e futur në përdorim nga **Andre Sant Lage** (André Sainte-Laguw: 1882-1950), matematikan francez, në fakt paraqet trajtë të modifikuar të **metodës d'Hondt**. Diskutoni! Kosova cilën metodë zbaton?

21.47. Për kontroll të zgjedhjeve duhet të ekzistojnë dy palë, **kontrolluesi** dhe **i kontrolluari**, të cilët janë **pjesëmarrës në zgjedhje**. Diskutoni këto tri kategori!

21.48. Kur ka filluar vëzhgimi i zgjedhjeve ë SHBA nga vëzhgues të huaj?

21.49. Kush është hartuesi i **Deklaratës së 2 korrikut** dhe çfarë ka thënë ai për të? Cilat veprime ndërmori Kosova dhe organet e saja të kohës pas Deklaratës së 2 korrikut? Pse nuk u njoh pavarësia e vendit në këtë kohë?

21.50. Diskutoni sistemin zgjedhor dhe zgjedhjet në Kosovë deri në shpalljen e pavarësisë më 17 shkurt 2008.

21.51. Diskutoni sistemin zgjedhor dhe zgjedhjet në Kosovë pas shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt 2008.

21.52. Aktualisht në **Republikën e Kosovës** ekzistojnë dy lloje të zgjedhjeve të drejtpërdrejta, pse jo tri? Diskutoni!

21.53. A zgjidhet Presidenti Kosovës në mënyrë të tërthortë apo drejtpërdrejt?

21.54. Kush i shpall zgjedhjet lokale në Kosovë?

21.55. Procedura sipas ankesës kushtetuese nga neni 113.7 i **Kushtetutës së Kosovës** asnjëherë nuk mund të çoj në anulim të zgjedhjeve, përsëritje të tyre të tërësishme ose të pjesshme, por vetëm në konstatimin e shkeljes kushtetuese dhe restaurimin e të drejtës apo lirisë së shkelur. Pse kjo është kësisoj dhe çfarë domethënie ka kjo?

21.56. Diskutoni sistemet zgjedhore në Shqipëri pas rënies së komunizmit? Çfarë sistemi zgjedhor ka sot Shqipëria dhe cilën metodë të përllogaritjes së votave e përdor?

21.57. Diskutoni sistemet zgjedhore në MV pas rënies së komunizmit? Çfarë sistemi zgjedhor ka sot ky vend fqinj me Kosovën dhe cilën metodë të përllogaritjes së votave e përdor?

21.58. Diskutoni sistemet zgjedhore në MZi pas rënies së komunizmit? Çfarë sistemi zgjedhor ka sot ky vend fqinj me Kosovën dhe cilën metodë të përllogaritjes së votave e përdor?

21.59. Diskutoni sistemet zgjedhore në Serbi pas rënies së komunizmit? Çfarë sistemi zgjedhor ka sot fqinji ynë verior dhe cilën metodë të përllogaritjes së votave e përdor?

21.60. Çka është **referendumi**?
21.61. Çka është **plebishiti**?
21.62. Çka është **vetoja popullore**?
21.63. Çka është **referendum paraprak** e *ç*ka **referendum i mëpastajmë**?
21.64. Çka është **referendumi abrogativ** e *ç*ka **referendumi konstitutiv**?
21.65. Çka është **referendumi detyrueshëm** e *ç*ka **referendumi fakultativ**?
21.66. Çka është **referendumi më një shumicë të rreptë** e *ç*ka **referendumi më një shumicë të butë**?
21.67. Çka është **referendumi kushtetues** e *ç*ka **referendumi ligjor**?
21.68. Çka nuk mund të jetë objekt referendumi në Kosovë?
21.69. Çka thotë KShq për referendumin?
21.70. Çka thotë KMVe për referendumin?
21.71. Çka thotë KMZi për referendumin?
21.72. Çka thotë KSerb për referendumin?
21.73. Çka është partia politike dhe a normohet me KKos?
21.74. Çka është sistemi partiak?
21.75. Kur vjen deri te ndalimi i punës së partisë politike?

22. Lexim shtesë

- Arend Lijphart, *Electoral Systems and Party Systems. A Study of Twenty-Seven Democracies 1945-1990* (Oxford University Press: Oxford, 1994)
- David Altman, Direct Democracy Worldwide (Cambridge University Press: Cambridge, 2011)
- Drude Dahlerup, Zeina Hilal, Nana Kalandadze, Rumbidzai Kandawasvika-Nhundu, *Atlas of Electoral Gender Quotas* (International IDEA: 2013)
- Erik S. Herron, Robert J. Pekkanen, Matthew S. Shugart (eds.), *The Oxford Handbook of Electoral Systems* (Oxford University Press: Oxford, 2018)
- EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION), *ELECTORAL LAW. CDL-EL(2013)006* (Council of Europe: Strasbourg, 3 July 2013)
- Guy S. Goodwin-Gill Free and Fair Elections New expanded edition (Inter-Parliamentary Union: Geneva 2006)
- Guy S. Goodwin-Gill, *CODES OF CONDUCT FOR ELECTIONS* (Inter-Parliamentary Union: Geneva, 1998)
- Jasna Omejec, *Konvencija za zaštitu ljudskih prava i temeljnih sloboda u praksi Europskog suda za ljudska prava* (Novi informator: Zagreb, 2014)
- Knut Heidar and Ruud Koole (eds.), *Parliamentary Party Groups in European Democracies. Political parties behind closed doors* (Routledge: New York, 2003)
- Kyriaki Topidi and Alexander H.E. Morawa (eds.), *Constitutional Evolution in Central and Eastern Europe* (ASHGATE: England, 2011)
- Marijana Pajvančić, *Parlamentarno pravo*. Drugo izdanje (Fondacija Konrad Adenauer: Predstavništvo Beograd, 2008)
- Norman Schofield and Itai Sened, *MULTIPARTY DEMOCRACY. Elections and Legislative Politics* (Cambridge University Press: Cambridge, 2006)
- Reuven Y. Hasan and Gideon Rahat, *Democracy within Parties. Candidate Selection Methods and Their Political Consequences* (Oxford University Press: Oxford, 2010)
- Richard Tarnas, *The Passion of the Western Mind: Understanding the Ideas That Have Shaped Our World View* (Ballantine Books: New York, 1991)
- Stanić Miloš*, "Raspodela mandata u evropskim postkomunističkim zemljama na primerima Poljske, Bugarske, Hrvatske i Makedonije*". *Strani pravni život* God. 57 Br. 3 (2013)

PJESA E KATËRT 4

ORGANIZIMI HORIZONTAL I PUSHTETIT

1. Mbi organizimin e pushtetit

Pushteti shtetëror është element i shtetit, që lidh **elementin personal** (popullsinë) dhe **material** (territorin) të shtetit në një bashkësi të tërësishme të njerëzve. Bashkësia shtetërore dallon nga bashkësitë tjera shoqërore pikërisht për shkak të **pushtetit**, i cili duhet të dallohet nga **forca.** Kjo e fundit paraqet aftësinë për të ndikuar në sjelljet e njerëzve në mënyrën që ata nuk e kanë zgjedhur. Në këtë kuptim, **forca nënkupton** "fuqinë mbi njerëzit" dhe ka tri forma të manifestimit. E para ka të bëj me fuqinë për të marrë vendim dhe për të ndikuar në përmbajtjen e tij. E dyta i referohet të kundërtës së kësaj, përkatësisht fuqisë për të penguar marrjen e vendimeve të një përmbajtjeje të caktuar. Së fundi, e treta fytyrë e fuqisë lidhet me kontrollin e mendimit (mundësia për të kontrolluar mendjen e dikujt, çka mendon dhe si mendon).

Sikundër shihet, këtu mungon një element, ai juridik apo sjellja e rregulluar me norma dhe e mbrojtur nga pushteti shtetëror. Për dallim nga forca, pra, **pushteti** është fuqia që bazohet në norma dhe për këtë arsye është legjitim. E parë në këtë kuptim, pushteti shtetëror identifikohet me sovranitetin si një cilësi e tij. Autoriteti politik ekskluziv që bazohet në të drejtën si produkt shoqëror, jo në forcën e pastër fizike, paraqet **sovranitet.** Kur identifikohet me pushtetin shtetëror, veçori themelore e sovranitetit shtetëror është se lirohet nga çdo pengesë dhe nënshtrim ndaj pushtetit tjetër shtetëror. Përjashtim nga kjo janë rastet e kufizimeve të marra mbi vete në mënyrë të lirshme dhe me vullnet nga ana e shtetit, gjë që përbën ushtrim të **sovranitetit të jashtëm**. Ndryshe, vullneti i shtetit mbizotëron mbi krejt vullnetet tjera të personave fizikë dhe juridikë të pranishëm në territorin shtetëror, si një shprehje e **sovranitetit të brendshëm**. Këto cilësi të pushtetit shtetëror bëjnë që ai të përfaqësojë një element tjetër të shtetit, **elementin juridik**, për arsye se paraqet të drejtën legjitime për të ndikuar në sjelljet e tjerëve, duke i detyruar të tjerët për t'iu nënshtruar urdhrave të pushtetit. Ky detyrim, në rast nevoje, vihet në jetë përmes ushtrimit të dhunës fizike, e cila paraqet monopol shtetëror dhe kontrollet nga shteti. Pushteti ushtrohet në bazë të rregullave juridike, qartësisht të pacaktuara më herët. Definimi kësisoj i shtetit, përkatësisht si marrëdhënie pushteti të njeriut ndaj njeriut, që bazohet në aftësinë për kontroll dhe ushtrim të dhunës fizike me bazë monopoli, për herë të parë është bërë nga **Maks Veber** (Max Weber: 1864-1920) në esenë e tij **Politika si profesion** (1919) dhe në shkrimet tjera të tij gjatë viteve 1919-1920. Në këtë ese, ai ka shtruar themelet e brendshme të legjitimitetit, i kuptuar si posedim i monopolit për ushtrim të dhunës fizike me qëllim vënien në jetë të rendit juridik: shteti shihet si garantues i vetëm i të drejtës për ushtrim të forcës fizike. Për rrjedhojë, politika nënkupton garën për një copë të pushtetit ose për ndikim në ndarjen pushtetit, qoftë mes shteteve ose mes grupimeve të njerëzve që gjenden në shtet. Në ndjekje të këtij definimi, Veber vë në dukje se ekzistojnë tri parime që arsyetojnë legjitimitetin e dominimit politik të shtetit: autoriteti tradicional, autoriteti karizmatik dhe autoriteti juridik. E thënë me fjalë të tjera, sipas **M. Veber**, nënshtrimi i individëve ndaj urdhrave apo kërkesave të shtetit përbën një çështje ekzistenciale, që ndodhë në ndonjërën prej tri formave të manifestimit të pushtetit, si në vijim:

- e para, autoriteti i pushtetit shtetëror rrjedh nga një **burim tradicional**, i cili ka qenë i tillë kaherë që nga kohët e vjetra (pushteti legjitimohet në respektim të formave kulturore të

krijuara dhe stabilizuara për një kohë të gjatë);
- e dyta, autoriteti i pushtetit shtetëror rrjedh nga një **lider karizmatik** që posedon cilësi të rralla që imponojnë nënshtrim ndaj tij (pushteti legjitimohet përmes aftësive të jashtëzakonshme të liderit që inspiron devotshmëri dhe nënshtrim); dhe,
- së fundi, autoriteti i pushtetit shtetëror rrjedh nga disa rregulla juridike të përcaktuara që më parë me të cilat normohen kompetencat e pushtetit shtetëror në mënyrë objektive (**legjitimiteti juridiko-racional** apo **pushteti burokratik**, ku pushteti legjitimohet nga rregullat e miratuara dhe rregullativa tjetër juridike).[1]

Klasifikimi veberian i tri formave të manifestimit të pushtetit, konsiderohet i rëndësishëm sot e kësaj dite. Atij, megjithatë, i bëhen vërejtje serioze, mbase edhe me vend, në veçanti sa i përket qasjes së tij tepër pozitiviste dhe racionaliste-juridike në arsyetimin e legjitimitetit të pushtetit shtetëror, duke përjashtuar nga skena çdo diskutim lidhur me përmbajtjen e kuadrit normativ mbi të cilin mbështetet legjitimiteti i ushtrimit të pushtetit shtetëror. Ky kuadër normativ kërkon që pushteti shtetëror të ketë në konsideratë të fuqishme disa **faktorë të tjerë përbërës**, të cilët mund të mos vërehen apo reflektohen në kuadrin normativ si legjitimues i pushtetit shtetëror, siç janë: mënyra e formimit të vullnetit politik, liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, sundimi i ligjit, siguria juridike dhe barazia, mosdiskriminimi në *çfarëdo* baze qoftë etj. E thënë me fjalë të tjera, nuk mjafton që kuadri normativ të jetë i vlefshëm dhe i detyrueshëm ndaj atyre që bien nën të, por duhet të jetë legjitim edhe në përmbajtje. Kjo e fundit, **përmbajtja e pushtetit**, përfshinë **vlerat dhe parimet** që sanksionon, mishëron dhe promovon. Kjo, në veçanti, ka rëndësi për aspektin që diskutohet në vijim: njohjen ndërkombëtare të regjimit politik të mbështetur nga pushteti i brendshëm shtetëror.[2] Edhe neo-veberianët janë fokusuar gati ekskluzivisht në kapacitetin e shtetit dhe institucioneve të tij për të ushtruar dhunë me qëllim të nënshtrimit. Ka pasur edhe të atillë që janë munduar të gjejnë te **Maks Veber**, në pjesën që lidhet me konceptin e tij mbi legjitimitetin e pushtetit shtetëror, aspekte përmbajtësore të vlerave dhe parimeve mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, sundimin e ligjit dhe sigurinë juridike, mbrojtjen e minoriteteve dhe mosdiskriminimin dhe kështu me radhë.[3] Po të ndiqej verbërisht arsyetimi veberian mbi legjitimitetin, atëherë edhe regjimet naziste dhe gjenocidale, ato që kanë qenë të bazuara në diskriminim racor, siç janë **Rodezia e Jugut** (Zimbabve e sotme) apo "Republika Sërpska" në **Bosnje-Hercegovinë**, do të duhej të pranoheshin si shtete me pushtet shtetëror legjitim. Kjo, megjithatë, nuk është kështu: për të qenë një pushtet shtetëror legjitim, ai duhet të përmbushë disa kushte dhe të posedojnë disa cilësi minimale që shkojnë përtej botëkuptimit veberian mbi **legjitimitetin juridiko-racional** apo **pushtetin burokratik**, ku pushteti legjitimohet nga rregullat e miratuara paraprakisht. Kjo paraqet vetëm cilësinë e parë dhe minimale, **condiction sine qua non**, që përcakton se pushteti duhet të ushtrohet sipas rregullave të paracaktuara juridike. Për të qenë legjitim, pushteti duhet të ketë substancë (përmbajtje). Ajo përmbajtje apo substancë nënkupton që këto rregulla juridike duhet të ngërthejnë edhe pikëpamjet e atyre me të cilët qeveriset, krahas pikëpamjeve të pushtetit. Përveç kësaj, legjitimiteti i pushtetit shtetëror, duhet domosdo të shpreh, jo vetëm pikëpamjet e atyre me të cilët qeveriset por edhe vetë **pëlqimin e tyre**.

Në shtet ekzistojnë edhe pushtete të tjera, siç janë: pushteti i shkollës, pushteti medial, pushteti i sindikatës dhe partive politike, pushteti i këshillave mbikëqyrës dhe këshillave administrativë në shoqëritë e ndryshme aksionare, pushteti i kishës dhe klerit dhe pushtete të tjera. Nga pushtetet

1 Tony Waters and Dagmar Waters (eds.), *Weber's Rationalism and Modern Society: New Translations on Politics, Bureaucracy, and Social Stratification* (Palgrave Maxmillan: Hampshire, UK, 2015) fq. 137–138.

2 Cf. më shumë në Donald H.J. Hermann, "Max Weber and the Concept of Legitimacy in Contemporary Jurisprudence" *De Paul Law Review* Vol. 33 No. 1 (Fall 1983) fq. 1-19 në fq. 4 & 23-29.

3 Cf. më shumë për këtë trajtimin e shkëlqyer dhe studioz të Philipp Lottholz & Nicolas Lemay-Hébert, "Re-reading Weber, re-conceptualizing state building: from neo-Weberian to post-Weberian approaches to state, legitimacy and state-building". *Cambridge Review of International Affairs*, Vol. 29 No. 4 (2016) fq. 1467–1485.

tjera, **pushteti shtetëror** dallon për shkak se në tërë territorin shtetëror ai është pushteti më i lartë, pushteti suprem, që ka **tri karakteristika të dallueshme** që janë të pashmangshme për çdo pushtet, pa marrë parasysh sa është legjitim në kuptimin si më sipër. Ato janë:

- **pavarësia;**
- **vazhdimësia;** dhe
- **pandashmëria**.

Pavarësia nënkupton se pushteti shtetëror nuk i nënshtrohet asnjë pushteti tjetër brenda dhe jashtë territorit shtetëror. **Vazhdimësia** e pushtetit shtetëror nënkupton që pushteti vazhdon, përkundër asaj që ndërrohen bartësit e tij. Së fundi, **pandashmëria** e pushtetit shtetëror nënkupton se pushteti shtetëror është një edhe atëherë kur ushtrohet nga shumë organe (sistemi ndarjes së pushteteve). Kur flitet për ndarjen dhe balancimin e pushtetit, flitet për një pushtet që quhet pushtet shtetëror. Si i tillë, pushteti manifestohet në tri trajta themelore: pushteti legjislativ, pushteti ekzekutiv dhe pushteti gjyqësor. Format e pushtetit shtetëror që nuk posedojnë këto cilësi i njeh historia (perandoritë, shtetet totalitare, protektoratet, shtetet vasale dhe kështu me radhë). Krahas kësaj ndarje klasike triadike të pushtetit shtetëror, nga gjysma e dytë e shekullit XIX, me lindjen, ngritjen dhe përhapjen e shtetit administrativ, kanë lindur **autoritetet e pavarura rregullative (agjencitë dhe institucionet e pavarura),** që ushtrojnë funksione shtetërore që i takojnë ndonjërit prej tri pushteteve klasike.

1.1. Funksionet

Pushteti shtetëror është një **institucion i tërësishëm** juridiko-kushtetues, njëjtë sikur shteti element i të cilit është, por ka **funksione** të ndryshme (kryen punë të ndryshme e të nduarnduarshme). Për këtë shkak pushteti i tërësishëm shtetëror ndahet në më shumë funksione, përmes së cilave ai manifestohet, realizohet, shihet, preket, ndihet. Në këtë kuptim funksionet e pushtetit shtetëror konsistojnë në përcaktimin e politikës, nxjerrjen e ligjeve, gjykim dhe veprimtari tjetër, që nuk është asgjë tjetër pos ushtrim i pushtetit shtetëror. Për këtë arsye shpesh njëjtësohen ndarja e funksioneve me ndarjen e pushteteve shtetërore. Sipas **kriterit objektiv**, funksionet shtetërore mund të ndahen në funksionin legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, të cilat në të njëjtën kohë paraqesin edhe tri degë të pushtetit shtetëror. Ky model shpesh cilësohet si **trias politica**.[4] Kjo krahasohet me fuzionimin e pushteteve në sistemin parlamentar ose gjysmëpresidencial, në të cilat mund të paraqiten përputhjet mes funksioneve dhe anëtarësimeve në degët e ndryshme, veçanërisht në legjislativ dhe ekzekutiv. Ndërsa kur merret parasysh **kriteri subjektiv**, përkatësisht organik i ndarjes së funksioneve shtetërore, atëherë fokusi vihet te dallimet mes të organeve që kryejnë funksione shtetërore. Parlamenti ka funksionin e ligjvënies, nganjëherë edhe të kushtetutëbërjes, ekzekutivi ka funksionin e ekzekutimit, kurse gjykatat funksionin e gjykimit. Së fundi, funksionet shtetërore mund të ndahen edhe sipas **llojit të akteve juridike** që sjellin: kushtetutat dhe ligjet janë produkt i kushtetutëbërjes dhe ligjvënies, akteve nënligjore dhe aktet administrative janë prodhim i funksionit ekzekutiv dhe administrativ, kurse aktgjykimet dhe vendimet gjyqësore janë fryt i ushtrimit të funksionit gjyqësor.

Përveç këtyre tri funksioneve klasike, ekzistojnë edhe disa veprimtari të tjera të shtetit, që nuk ushtrohen nga asnjëra prej gjymtyrëve kryesore të pushtetit shtetëror si më sipër, e megjithatë përfaqësojnë autoritet publik, përkatësisht pushtet publik. Këto janë **autoritetet rregullative**, institucionet dhe agjencitë e pavarura dhe autonome, të cilat ushtrojnë në mënyrë specifike funk-

[4] Doktrina **trias politica** përshkruan ndarjen strikte të pushtetit, duke lënë çështjet politike në duart e ekzekutivit dhe duke kufizuar punët e gjyqësorit në çështjet e ligjit. Cf. më shumë Lukas van den Berge, "Montequieu and Judicial Review of Proportionality in Administrative Law: Rethinking the Separation of Powers in the Neoliberal Era" *European Journal of Legal Studies* {Vol. 10 No. 1 (2017), fq. 217-233 në fq. 204 e tutje.

sione gjysmë ligjvënëse, gjysmë ekzekutive dhe gjysmë gjyqësore. Këtyre iu kushtohet seksioni i fundit në këtë pjesë, para se të kalojmë në seksionin mbi komentet dhe pyetjet. Të ngjashme me to, por tërësisht të ndryshme, janë edhe funksionet që kryejnë gjykatat kushtetuese - mbrojtjen dhe sigurimin e supremacisë së kushtetutës së vendit. Kjo është arsyeja pse shtjellimet tona për gjykatën kushtetuese pasojnë shtjellimet mbi gjyqësorin.

Përveç kësaj veprimtarie shtetërore apo publike që kryhet nga të tjerët që nuk janë pushtet shtetëror në kuptimin klasik të fjalës, ekzistojnë edhe disa **funksione socio-politike**, që nuk i takojnë fare sferës juridike dhe që dallojnë nga funksionet që i kryejnë autoritetet rregullative, agjencitë dhe institucionet e pavarura dhe autonome që operojnë brenda shtetit bashkëkohor. Funksionet socio-politike të shtetit nuk janë në tërësi një çështje juridike. Atyre nuk mund t'u jepet paraprakisht një cilësim juridik, gjë e cila bëhet më pastaj nga ana e juristëve, pra jo nga ana e kushtetutëbër**ësit** apo e ligjvënësit nacional. E thënë me fjalë të tjera, **funksionet socio-politike**, nuk figurojnë me titull të njëjtë në listën e menysë që një shtet i përzgjedh e vendos në kushtetutën e vet. Si të tilla, ato realizohen në hapësirën publike, jo në hapësirën shtetërore në kuptimin e ngushtë të fjalës: nuk duhet të përzihet aktiviteti shtetëror me aktivitetin publik dhe hapësirën publike. Mbi bazën e kësaj dallohen të gjitha funksionet shtetërore: ato janë aktivitete shtetërore që shfaqen në dy forma kryesore.[5] Forma e parë janë aktivitetet që shpërfaqin identitetin e dukshëm të shtetit si institucion dhe që imponohen me vetë dukjen e tyre (**funksionet e dukshme socio-politike të shtetit**). Në formën e dytë hyjnë format e reja të aktiviteteve shtetërore, që nuk janë të dukshme dhe që nuk imponohen me dukjen e tyre (**funksionet latente socio-politike të shtetit**).[6]

Aktivitetet shtetërore që **imponohen me dukjen e tyre**, historikisht shikuar, nga autorët klasikë të së drejtës kushtetuese, janë futur në grupin e funksioneve të shtrëngimit ose të ofrimit të përfitimeve. Mbi bazën e kundërvënies së funksioneve urdhëruese, të cilat shteti me metoda shtrënguese i implementon, dhe funksioneve të përfitimit, që shteti i realizon pa pasur nevojë të përdor shtrëngimin, janë ndërtuar botëkuptimet mbi **tri funksionet kryesore socio-politike të shtetit: funksioni i komandimit (urdhërimit),** funksioni i ofrimit të përfitimeve dhe, së fundi, funksioni ndërkombëtar. Ky i fundit rrjedh si nevojë dhe domosdo e shtetit me qëllim të realizimit me sukses të dy funksioneve të para.[7] **Në pjesën e funksioneve të dukshme socio-politike** hyjnë edhe klasifikimet mbi **shtetin policor** versus **shtetin e shërbimit** si dhe klasifikimet mbi **shtetin rregullativ** versus **shtetin e përfitimeve**. Mbi bazën e kësaj ndarje identifikohen funksionet dominante të shtetit: **shteti i së drejtës** thuhet se më shumë identifikohet me realizimin e funksioneve shërbyese dhe të mirëqenies, ku shteti shërben si një demarkues i vijës së ndarjes në mes të ofrimit të përfitimeve dhe kufizimit të lirive individuale me qëllim të ruajtjes së lirisë si vlerë sublime e shoqërisë. E thënë me fjalë të tjera, **shteti i së drejtës** ka për funksion primar sigurimin e autonomisë së individit dhe lojës apo veprimit të lirë të subjekteve të së drejtës. Ky lloj shteti cilësohet edhe si **shtet minimal** sepse funksionet e shtetit realizohen në një mënyrë shumë minimale, aq sa për të siguruar hapësirën publike, duke mos lejuar që të përzihet kjo hapësirë me hapësirën shtetërore, ashtu që individi dhe shoqëria të kenë mundësi për të realizuar aspiratat e tyre (reale dhe të imagjinuara). Këtij shteti i kundërvihet **shteti intervencionist**, që në fillim ka lindur dhe është identifikuar me **shtetin social**, por që nuk janë të njëjtë. Ky i fundit përfaqëson gjendjen kur burokracia rritet deri në masën fatale sa që absorbon funksionet e shtetit në tërësinë e tyre dhe i shkrinë në një funksion të vetëm: orientimin kah realizimi i mirëqenies së përgjithshme. Kur **shteti intervencionist** ka formën e **shtetit social**, por që përmban kufizime juridiko-kushtetuese të pushtetit politik, atëherë bëhet fjalë për dominim të funksioneve shërbyese të shtetit në dobi të

[5] Jacques Caillosse, "Les fonctions socio-politiques de l 'Etat". Në Michel Troper et Dominiques et Chagnollaud (eds.), *Traité international de droit constitutionnel. Tome 3: Suprématie de la Constitution* (Dalloz: Paris, 2012) fq. 321-356 në fq. 325-326, 329.

[6] Ibid., 341-352.

[7] Ibid., 342.

individit, por që shoqërohet me rritje të burokracisë. Kur shteti intervencionist ka masë të madhe burokratike, pa një kufizim formal apo material të pushtetit politik, atëherë bëhet fjalë për **absorbim të shoqërisë civile dhe identifikim të shtetit me shoqërinë**: këtu dominojnë funksionet shtrënguese dhe represive të njëanshme, pa asnjë pikë referimi në vullnetin e individit dhe qytetarit, të cilët janë të nënshtruar në tërësi ndaj tij me metoda të dhunshme.

Një ndarje tjetër e funksioneve që shfaqet në literaturë, dhe që reflekton aspektet socio-politike të funksioneve shtetërore, është ndarja në **funksione të sovranitetit** dhe në **funksione të solidaritetit**, që afërsisht përputhen me klasifikimet e mësipërme të funksioneve të dukshme të shtetit. Në vartësi të dominimit, më pastaj bëhet klasifikimi edhe i shteteve: aty ku shprehet më shumë **funksioni i sovranitetit**, vjen deri te ndërtimi i shteteve moderne, si institucione që kanë shkatërruar rendin feudal dhe i kanë hapur rrugën trendëve zhvillimore nëpër të cilat ka kaluar njerëzimi. Në rastin e dominimit të funksioneve të solidaritetit, atëherë vjen në shprehje cilësimi i shteteve si **shtete rregullatore**, sepse shteti paraqitet si ofrues i shërbimeve dhe i të mirave për individin dhe shoqërinë si tërësi. Nganjëherë flitet për **shtetin prodhues** dhe **shtetin operator**. Tërë ky klasifikim bëhet me qëllim të vënies jo të sovranitetit territorial por të funksionit socio-politik që shteti realizon si institucion, gjë që nganjëherë apo shpeshherë tejkalojnë kufijtë shtetërorë. Kjo derivon funksione të tjera që mund të identifikohen si **funksione lokale**, **regjionale** dhe **globale të shtetit modern.**[8]

Sa i përket **funksioneve socio-politike latente të shtetit**, cilësohen si të tilla për shkak se nuk mund të identifikohen në mënyrë të dukshme me funksionet shtetërore, që vjen si pasojë e kompromitimit të tyre nga ngritja e shtetit modern menaxherial. Ky i fundit, **shteti menaxherial**, duke u indeksuar në modelin e një institucioni të ndërmarrësisë/menaxhimit/administrimit, ka shpërfillur të gjitha funksionet gjenealogjike apo funksionet prindërore (të përkujdesjes) që kanë pasur dhe i kanë akoma shtetet moderne. Ky funksion në literaturë është cilësuar edhe si **funksion totemik**, si vetë esenca e aspektit **antropologjik** të shtetit**,** në kuptim të asaj që shteti shpërfaqet në formën e **garantuesit të vazhdimësisë antropologjike**, me qëllim të reprodukimit të energjisë së domosdoshme për jetë dhe reprodukim të asaj që njerëzimi e quan **pushtet**. Në këtë kuptim, shteti paraqitet si një institucion, si një prej zbulimeve më të mëdha të njeriut, jo vetëm pse transformon energjinë njerëzore, duke e kthyer atë në shërbim të një funksioni mekanik (marrëdhënia e pushtetit, si marrëdhënie në mes të atyre që qeverisin dhe atyre me të cilët qeveriset - marrëdhënia nënshtrimit **në shtetet e proveniencës jodemokratike dhe joliberale perëndimore),** por edhe për shkak se ai kryen funksionin e njëjtë me sistemet mitologjike apo religjioze që sigurojnë mbijetesën e vetvetes, duke shërbyer kësisoj si një normë e organizimit social.[9]

Pa pretenduar se po bëjmë një indeksim shterues të **funksioneve kryesore socio-politike** të shtetit, funksioneve të hapura dhe funksioneve latente, për arsye didaktike dhe me qëllim të lehtësimit të kuptimit më të mirë të tyre, në vijim përmendim shkarazi disa prej funksioneve më reprezentative me të cilat asocohet shteti modern sot. Pa hy në diskutimin e tyre, ato janë grupuar në disa tërësi, si në vijim:

- funksioni i sigurimit të shtetit dhe shoqërisë (funksioni ekzistencial);
- funksioni klasor;
- funksioni paqësor;
- funksioni i realizimit të lirisë;
- funksioni i ofrimit të sigurisë sociale;
- funksioni i bashkëpunimit dhe integrimit.

[8] Jacques Caillosse, "Les fonctions socio-politiques de l'Etat", fq. 348-349.
[9] Ibid., fq. 350.

1.2. Organizimi i pushtetit: teoria dhe praktika

Në kuptimin shtetëror-juridik dhe politik, pushteti shtetëror konceptohet si një dhe i unifikuar. Veprimi i pushtetit shtetëror, i shtetit dhe trupave të tij, ndërkaq, çdo herë ndodh sipas një modeli të caktuar të organizimit të pushtetit. Organizimi i pushtetit, në rend të parë, është marrëdhënie juridike dhe politike në mes të organeve të ndryshme të pushtetit shtetëror në nivel qendror (**organizimi horizontal**) dhe, së dyti, marrëdhënie juridike dhe politike në mes të organeve të pushtetit qendror dhe pushtetit në nivel më të ulët - pushtetit regjional, lokal dhe pushtetit në njësitë federale (**organizimi vertikal**). Kjo marrëdhënie është **juridike** sepse përcaktohet me kushtetutë e ligje dhe aktet të tjera relevante juridike apo sipas praktikës kushtetuese, kurse ka karakter **politik** nga shkaku se marrëdhënia në fjalë ka të bëjë me ushtrimin e funksioneve shtetërore, përkatësisht me ushtrimin e pushtetit. Në këtë organizim të pushtetit shtetëror hyjnë: tërësia e institucioneve shtetërore, funksionet, kompetencat dhe mënyra e zgjedhjes apo formimit të tyre dhe, në fund, marrëdhëniet reciproke mes veti.[10] Në këtë kuptim, pushtetin shtetëror e ushtrojnë, sipas kushtetutës së shkruar apo sipas praktikës kushtetuese, organet e pushtetit në sferën ligjvënëse, ekzekutive dhe gjyqësore, përfshirë gjyqësinë kushtetuese, si dhe organet tjera të pushtetit në nivel regjioni, lokal dhe të njësisë federale. Në mesin e trupave të pushtetit shtetëror, përkatësisht organeve të pushtetit shtetëror ekzistojnë **organet që themelohen drejtpërdrejt me kushtetutë** dhe **organet që kanë rëndësi kushtetuese**. Në grupin e parë hyjnë krejt ato organe shtetërore që zënë pozitën e autonomisë së kualifikuar (**superiorem non recognoscens**) dhe që konsiderohen pushtet shtetëror në kuptimin e ngushtë dhe të plotë të fjalës, marrin pjesë në mënyra të ndryshme në realizimin dhe ushtrimin e funksionit politik të shtetit, përkatësisht marrin pjesë drejtpërdrejt në individualizimin e qëllimeve që shteti ia ka vënë vetes dhe synon t'i realizojë. Kjo është rezultat i sovranitetit të shtetit, të cilin e përkthen në norma kushtetuese dhe trajta institucionale të realizimit të tij të drejtpërdrejtë, duke përcaktuar vetë fizionominë e tyre. Këto trajta institucionale apo organe i cakton në mënyrë të drejtpërdrejtë kushtetutëbërësi, ashtu që ato në mënyrë të caktuar shprehin normën e kushtetutës. Të tilla janë organet qendrore që me kushtetutë vishen me funksion legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor në nivel nacional (përfshirë gjyqësinë kushtetuese). Funksionet dhe kompetencat e tyre janë të përcaktuara me vetë kushtetutën e vendit. Në grupin e dytë, ndërkaq, përkatësisht në **organet që kanë rëndësi kushtetuese** hyjnë të gjitha organet tjera që nuk marrin pjesë në realizimin e **funksionit politik të shtetit**, por janë të një rëndësie esenciale për strukturën kushtetuese të shtetit. Veprimtarinë e tyre më së shpeshti e përcakton ligjvënësi. Të tilla organe janë, ta zëmë, gjykatat.[11] Këtu hyjnë, pa asnjë diskutim edhe **autoritetet e pavarura rregullative (agjencitë dhe institucionet e pavarura)**, që formojnë makinerinë administrative të shtetit, si një sferë e veçantë e autoritetit publik që nuk mund të klasifikohet në ndarjen triadike klasike të pushtetit shtetëror në legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.[12] Në mesin e organeve që themelohen drejtpërdrejt me kushtetutë dhe organeve shtetërore që themelohen me ligj dhe aktet të tjera më të ulëta se ligji, ekziston **marrëdhënia e hierarkisë**. Ajo hierarki mund të jetë e dyfishtë. Në rend të parë mund të ekzistoj hierarkia në mes të organit përfaqësues (ligjvënësit) dhe ekzekutivit (qeverisë). Pas kësaj mund të ekzistoj hierarkia në mes të qeverisë dhe organeve të tjera të administratës dhe në mes të gjyqeve të gjyqësorit të rregullt, përkatësisht në mes të organeve të ulëta dhe të larta administrative dhe organeve gjyqësore.

Organizimi shtetëror i pushtetit mund të kundrohet nga aspekti i **marrëdhënies horizontale** dhe **marrëdhënies vertikale** të shtrirjes së ushtrimit të tij. Ndarja e pushtetit dhe e organeve që qëndrojnë në një rrafsh të njëjtë të shtrirjes së ushtrimit të tij quhet **ndarje horizontale**. Këtu hyjnë organet më të larta të shtetit, që janë bartës të funksionit ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor dhe në disa vende edhe pushtetit në sferën e sigurimit të supremacisë së kushtetutës (kushtetutshmëria). Ushtrimit të këtyre funksioneve u korrespondojnë organet si vijon: parlamenti, qeveria, shefi shtetit, gjyqet dhe

[10] Mladen Vukčević, *Komentar Ustava Crne Gore* (*Univerzitet Mediteran*: *Podgorica*, 2015) fq. 215.
[11] Arsen Bačić, *Komentar Ustava Republike Hrvatske* (Pravni fakultet u Splitu: Split, 2002) fq. 184.
[12] M. J. C. Vile, *Constitutionalism and the Separation of Powers.* 2nd Edition (Liberty Fund, Inc.: USA, 1998), fq. 400.

gjykata kushtetuese (ose organi tjetër i barasvlefshëm me të). **Sipas kushtetutës, këto organe duhet të jenë organe të rangut të njëjtë dhe, në të njëjtën kohë, të rangut më të lartë në shtet**. Në jetën reale, u mor vesh, kjo nuk mund të arrihet: disa organe veçohen dhe ngrihen mbi të tjerat shkaku i pozitës së tyre juridiko-kushtetuese dhe forcës politike që posedojnë në realitet.

Sipas sistemit të **ndarjes vertikale** të pushtetit, organet vendosen në nivele të ndryshme të strukturës shtetërore, me fillim nga organet qendrore në kulm, pastaj vijnë organet e njësive federale, të pushtetit të regjioneve dhe ato të nivelit lokal. Analiza e organizimit vertikal të pushtetit jep përgjigje në pyetjen nëse shteti është i centralizuar ashtu që krejt pushteti ushtrohet nga një qendër, qendra më e lartë shtetërore, apo ai është i decentralizuar ashtu që organet joqendrore në njësi federale, regjion apo në nivel lokal kanë një autonomi të caktuar në vendosje dhe ekzekutim të vendimeve. Ndarja vertikale e pushtetit diskutohet në pjesën e fundit të librit.

Organizimi horizontal **klasik** i pushtetit përbëhet nga organet ligjvënëse, ekzekutive dhe gjyqësore. Kjo është ndarja trepalëshe e pushtetit që është më e përhapur dhe më e përqafuar në botën bashkëkohore, e cila teorikisht plotësohet me një ndarje katërpalëshe, që përfshinë pushtetin administrativ. Në shumicën e vendeve të botës demokratike ekziston një pushtet i gjyqësisë kushtetuese që ushtrohet nga gjykatat kushtetuese (apo organet e barasvlefshme me to). Këto të fundit zakonisht janë jashtë sistemit të rregullt gjyqësor. Marrëdhënia në mes të pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor formon **sistemin e pushtetit**. Për sistemin e pushtetit në të vërtetë, gjëja më e rëndësishme është marrëdhënia në mes të pushtetit ligjvënës dhe pushtetit ekzekutiv, si pushtete politike, kurse pushteti gjyqësor si një pushtet absolutisht i pavarur gjendet në një pozitë më të ndryshme. Është marrëdhënia e legjislativit me ekzekutivin ajo që përcakton **sistemin e pushtetit** - **sistemin parlamentar**, **presidencial** dhe **kuvendor** (apo sistemi i pushtetit i kuvendeve). Përveç këtyre sistemeve themelore të pushtetit, ekzistojnë edhe **sistemet e përziera të pushtetit**, më i njohuri nga të cilët është **sistemi gjysmëpresidencial**.

Ndarja **horizontale** dhe **vertikale** e pushtetit shpërfaqin brendinë e shtetit, strukturën nga e cila përbëhet. Me analizën e nivelit të pushtetit, pozitës juridike dhe politike të organeve të pushtetit dhe kompetencave të tyre, arrihet në pikturën gjithëpërfshirëse të shtetit, të asaj që nënkuptohet dhe përfshihet me këtë nocion. Kritika e strukturave dhe formave të ndryshme të pushtetit ndihmon në gjetjen e përgjigjes në pyetjen se cili model (lloj, formë, tip) i organizimit të pushtetit është më i miri për një shoqëri konkrete. Kështu, në këtë mënyrë, një shtet do të pranojë ndarjen e rreptë të pushtetit dhe sistemin presidencial (**SHBA**), një tjetër do pranojë ndërvarshmëri më të madhe të organeve të pushtetit dhe sistem parlamentar (**Gjermania**), kurse i fundit do të provoj pjesërisht realizimin e pjesshëm të parimit të unitetit të pushtetit (**Zvicra**, ku parlamenti federal ka autoritetin më të madh në vend). Përpunimin më të detajuar të parimit të ndarjes së pushtetit e gjejmë pak më vonë, te një autor tjetër, me inspirim të ngjashëm me pareranedësit e tij, përkatësisht me inspirim nga sistemi kushtetues anglez i kohës. E kemi fjalën për veprën e **Monteskies** (Baron de Montesquieu: 1689-1755**)** "Fryma e ligjeve" ("De l'espit de lois"), botuar për herë të parë në vitin 1748.[13] Në këtë vepër, ai ka përpunuar teorinë mbi ndarjen e pushtetit në mënyrë të plotë, duke vënë kësisoj themelet e saj moderne. Është e vërtetë, megjithatë, që **Monteskie** nuk e ka zbuluar doktrinën e ndarjes së pushteteve, dhe shumica e asaj që ai ka thënë në librin XI, kapitulli 6 i veprës "Fryma e ligjeve" është marrë nga shkrimtarët anglez të kohës, në rend të parë nga **Xhon Lloku** (John Locke: 1632-1704).[14] Jo vetëm në Angli, por edhe gjetiu, para **Monteskies** dhe kohës moderne është menduar e diskutuar mbi ndarjen e pushtetit, të një lloji të atillë që të ndihmonte në organizimin sa më të mirë të pushtetit

[13] Botimi standard i *De l'Esprit des Loix* është nga J. Brette de la Gressaye, Paris, 1950, 4 vëllime. Citimet janë nga përkthimi i bërë nga Thomas Nugent, nën edicionin e F. Neumann, New York, 1949.

[14] Mbi origjinën angleze të doktrinës mbi ndarjen e pushtetit, cf. më shumë në Girard Albert, "Joseph Dedieu. Montesquieu et la tradition politique anglaise en France. Les sources anglaises de l'Esprit des Lois, 1909". *Revue d'histoire moderne et contemporaine*, Tome 14 No. 1 (1910), fq. 95-97.

shtetëror. Trajtat e hershme të ”ndarjes së pushtetit” njihen me emrin ”qeverisje ose kushtetutë e përzier” (“mixed constitution”/”mixed government”). Dallimi mes **qeverisjes së përzier** dhe ndarjes së pushteteve konsiston në atë se qeverisja e përzier nuk bazohet në ndarjen e pushtetit sipas degëve, por duke u bazuar në shtresat ekonomike dhe gjendjen pasurore të bartësve të pushtetit. Në praktikë, në kohët moderne ky lloj i qeverisjes është asocuar me përvojën e Anglisë nga fundi i Mesjetës si dhe me mendimtarët e hershëm antikë, ata mesjetarë dhe modernë, me fillim nga **Platoni** (Plato: ka jetuar dhe ka vdekur në Athinën klasike, koha e saktë e lindjes dhe vdekjes nuk dihen) e deri te **Ruso** (Jean Jacques Rousseau: 1712-1778). Kontributi i **Monteskies,** ndërkaq, qëndron në futjen e ideve të reja në doktrinën mbi ndarjen e pushtetit: ai vuri theksin te disa elemente që më parë i kishin ikur vëmendjes së shkrimtarëve të tjerë të kohës, veçanërisht lidhur me gjyqësorin dhe i dha doktrinës një peshë më të madhe se autorët tjerë paraprakë. Në këtë kuptim, ndikimi i **Monteskies** nuk konsiston në origjinalitetin e doktrinës së tij por në mënyrën dhe kohën e zhvillimit të saj nga ai.

Para instalimit të saj në **Angli** më 1653 me **Instrumentin e Qeverisjes**, megjithatë, **qeveria/ kushtetuta e përzier** ka ardhur në shprehje në kolonitë angleze në Amerikën e Veriut, fillimisht në **Plymouth** e më pastaj edhe në kolonitë tjera. Në vitin 1620, separatistët anglezë kalvinistë të **kishave kongregacionale** dhe **anglikane**, më vonë të njohur si **Etërit e Pelegrinazhit**, formuan kolloninë **Plymouth** në Amerikën e Veriut dhe duke gëzuar vetëqeverisjen themeluan një sistem qeverisjeje demokratike dypalëshe. Njerëzit e lirë zgjodhën **Gjykatën e Përgjithshme** (“General Court”), që ka funksionuar si legjislaturë koloniale e **Plymouth**-it prej vitit 1620 deri në vitin 1690. Ky trup ka shërbyer edhe si gjykatë apeli dhe ka pasur të drejtën e zgjedhjes së guvernatorit, i cili, së bashku me shtatë “ndihmësit” e vet kanë ushtruar funksionin e pushtetit ekzekutiv.[15] Qeveri apo kushtetuta të ngjashme kanë pasur edhe koloni të tjera, si ato në **Masaçusec**, e krijuar më 1628, **Ishujt Rode**, e krijuar më 1636, **Konektikat**, e krijuar më 1636, **Nju Xhersi**, e krijuar më 1660 etj. Të gjitha bazoheshin në ndarjen e pushteteve, me përjashtim të kolonive **Playmouth** dhe **Masaçusec**, që kishin futur lirinë fetare si shtesë në sistemet e tyre demokratike, një hap ky i rëndësishëm në zhvillimin e të drejtave njerëzore.[16] Këto forma të zhvillimit demokratik në kolonitë e Amerikës së Veriut kanë ndikuar shkrimet e **Xhon Llokut** (John Locke: 1632-1704) dhe teorinë e tij mbi ndarjen e pushtetit në pushtet ligjvënës, ekzekutiv dhe federativ, në njërën anë, si përgjegjës për mbrojtjen e vendit, dhe në prerogativa të kurorës, në anën tjetër. Kanë qenë doktrinat kalviniste mbi ndarjen e pushtetit që u zbatuan nga ata që themeluan këto koloni: idetë e **Xhon Kalvin** (John Calvin: 1509-1564) favorizonin një sistem të qeverisjes që ndante pushtetin politik mes demokracisë dhe aristokracisë (qeverisja e përzier apo “mixed governemnt”). Ai ka vlerësuar lartë përparësitë e demokracisë, duke parë atë si një dhuratë nga Zoti që lejon popullin të zgjedh qeverinë dhe zyrtarët e vet. Për të reduktuar rrezikun nga shpërdorimi i pushtetit, **Kalvini** ka propozuar disa institucione politike që duhet të përplotësojnë dhe kontrollojnë njëri-tjetrin në një sistem të kontrollit dhe balancimit.[17] Në këtë mënyrë, **Kalvini** dhe ndjekësit e tij rezistuan absolutizmin politik dhe shtynë përpara rritjen e demokracisë.[18]

---

15 Christopher Fenell, “Playmouth Colony Legal Structure“. Në internet: http://www.histarch.illinois.edu/ plymouth /ccflaw.html (shikuar më 23 tetor 2022).

16 Clifton E. Olmstead, *History of Religion in the United States* (Prentice-Hall, Inc.: Englewood Cliffs, N. J., 1960), fq. 99-105, 114-116.

17 Simpatitë republikane të **Kalvinit** kanë buruar nga pikëpamjet e tij mbi natyrën njerëzore si thellësisht me të meta. Qeveritë e përziera, sipas tij reflektojnë realitetin se brishtësia e njeriut domosdo kërkon dhe ka nevojë për kontroll dhe balancim të pritjeve të zyrtarëve për abuzim me pushtetin. Ka qenë kjo qasje mbi kontrollin dhe balancin e pushtetit që ka shërbyer si bazë e teorisë së tij mbi rezistencës, sipas së cilës zyrtarët më të ulët kanë detyrim të rezisotojnë apo frenojnë sovranin tiranik. Cf. Lee Ward, *Modern Democracy and the Theological-Political Problem in Spinoza, Rousseau, and Jefferson* (Palgrave Macmillan: New York, 2014) fq. 24-25.

18 Clifton E. Olmstead, *History of Religion in the United States*, fq. 9-10.

Shtjellimet teorike të qeverisjes apo kushtetutës së përzier, sikundër u tha, nisin me **Platonin**,[19] dhe **Aristotelin**,[20] vazhdojnë me **Polibin**,[21] **Ciceronin** (Cicero: 109 p.e.s. – 43),[22] **Toma Akuinin** (Thomas Aquinas: 1225-1274),[23] **Marsilion nga Padova** (Marsiglo da Padova: 1275-342),[24] **Makiavelin**,[25] **Hugo Grocin**,[26] deri te **Zhan Zhak Ruso**.[27] Kushtet për lindjen e teorisë moderne evro-

[19] **Platoni** konsideron monarkinë, arsitokracinë dhe demokracinë si forma të qeverisjes së "mirë", kurse në format e "këqija" fut tiraninë, oligarkinë dhe anarkinë, të cilat janë shpërfytyrime të formave të mira. Cf. Plato, *Republic*. Translated by C. D. C. Reeve (Hackett Publishing Company: Indianapolis and Cambridge, 2005), fq. 239.

[20] **Aristoteli (Aristotle: 384 p.e.s. – 32 p.e.s.)** i pari ka përmendur idenë e "qeverisjes së përzier" apo qeverisë hibride, duke u bazuar në shumësinë e formave kushtetuese të qytete-shteteve në Greqinë antike. Cf. Andreë Linrott, "Aristotle and the Mixed Constitution". **Në Roger Brock and Stephen Hodkinson (eds.),** *Alternatives to Athens: Varieties of Political Organization and Community in Ancient Greece* **(**Oxford, 2002; online edn, Oxford Academic, 1 Jan. 2010). Në internet:https://doi.org/10.1093/acprof:oso/9780199258109. 003.0009 (qasur më 22 tetor 2022).

[21] Sipas **Polibit** (Polybius: rreth vitit 200 p.e.s. deri 118 p.e.s.), në Republikën romake, Senati romak, konsujt dhe asambletë kanë shpërfaqur shembullin e qeverisjes së përzier. Ka qenë **Polibi** ai që i pari ka përshkruar dhe shpjeguar sistemin e kontrollit dhe balancit në mënyrë të detajuar, duke u mbështetur në **Likurgun e Spartës** si shembulli i parë i qeverisjes së tillë. Cf. Polybius, *The Complete Histories of Polybius Paperback* (Digireads. com: January 1, 2009), Libri 6, fq. 11-13.

[22] Futja e idesë së kushtetutës apo qeverisjes së përzier nga Ciceroni ( ) në veprën e tij De re publica ( ), mund të kuptohet vetëm në dritën e situatës së tij personale dhe rrethanave bashkëkohore politike. Angazhimi i tij personal në jetën publike në një kohë kur Republika romake gradualisht po transformohej në monarki, me synimin për të restauruar rolin e rëndësishëm të aristokracisë, që përfaqësohej nga Senati romak. Për Ciceronin, kushtetuta e përzier ka qenë kryesisht një instrument për restaurimin e balancit të humbur mes Konsujve, Senatit dhe Comitia (Asambleja e popullit), një shans e fundit për të shpëtuar republikën që po kalbej. Cf. më shumë në Elizabeth Asmis, "A New Kind of Model: Cicero's Roman Constitution in 'De republica". *The American Journal of Philology* Vol. 126, No. 3 (Autumn, 2005), fq. 377-416.

[23] Duke ndjekur **Aristotelin**, Aquini ka argumentuar se krejt regjimet mund të ndahen në gjashtë lloje bazike, të cilat përcaktohen sipas dy kritereve: si qeveriset dhe nëse qeveriset në mënyrë të drejtë, përkatësisht për të mirën e përgjithshme. Ai më tutje shpjegon se qeverisja politike mund të ushtrohet nga shumësia, disa syresh, dhe nga një person. Një regjim i drejtë mund të jetë monarki ose mbretëri, atëherë kur ushtrohet nga një individ, aristorkraci kur ushtrohet nga disa individë, dhe republikë kur pushteti ushtrohet nga shumica. Një regjim është i padrejtë kur ushtrimi i pushtetit bëhet për dëshirën e sundimtarit, jo për interesin e përgjithshëm, dhe ka trajtat si vijon: tirani, kur pushteti ushtrohet nga një person; oligarki, kur pushteti ushtrohet nga disa; dhe, së fundi, demokraci, kur pushteti ushtrohet nga shumësia. Cf. St. Thomas Aquinas, De Regno: On Kingship Paperback Divine Providence Press: Milwaukee, 2014) Book 1, Chapter 1; Cf. edhe në James M. Blythe, *Ideal Government and the Mixed Constitution in the Middle Ages* (Princeton University Press: Princeton, 2014), kapitulli 3 "Thomas Aquinas", fq. 39-59.

[24] Marsilio botoj **Defensor Pacis** në vitin 1324. Filozofia e tij politike dhe teoria juridike si pikënisje kanë Aristotelin, me të cilin pajtohet se qëllimi i qeverisjes është plotësimi racional i dëshirës natyrore të njeriut për jetë të mjaftueshme. Marsilio, megjithatë, shkon përtej Aristotelit dhe përqafon një formë të republikanizmit që sheh popullin si burimin e vetëm të legjitimimit të autoritetit politik. Sovraniteti i takon popullit, i cili duhet të zgjedh, korrigjoj dhe, nëse kërkohet, edhe të rrëzoj liderët politik. Demokracia, argumneton Marsilio, është forma më e mirë e qeverisjes sepse ka prirje për sjelljen e ligjeve më të menqura, mbrojtjen e dobive të përgjithshme, promovimin e "mjaftueshmërisë së jetës" dhe prodhimit të ligjeve që kanë gjasa të mëdha për të qenë të respektuar. Cf. Marsilius of Padua, *Defensor Pacis*. Translated by Alan Geëirth (Harper & Roë: New York, 1967), fq. 13, 46-47.

[25] **Makiaveli** (Niccolò Machiavelli: 1469-1527) ka besuar se kushtetutat e mira nuk mund të zgjasin në mënyrë të pavarur. Për këtë arsye ai ka propozuar kushtetutën apo qeverisjen e përzier, të përbër nga monarkia, aristokracia dhe demokracia. Për te Roma ka qenë shembulli më i mirë i madhështisë së kushtetutës republikane, përkatësisht kushtetuës së përzier. Cf. Fabio Raimondi, "Republic and Constitution in Machiavelli's Discourses". Në Diogo Pires Aurélio and Andre Santos Campo (eds.), Machiavelli's Discourses on Livy: New Readings (Brill: Leiden, 2021), fq. 99-115 (kapitulli 5).

[26] **Hugo Groci** (Hugo Grotius: 1583-1645) në De Jure Belli et Pacis (1625) dhe në veprat tjera flet për republikanizmin dhe konstitutcionalizmin antik, duke elaboruar teoritë antike mbi pjesmarrjen e shumë shtresave në sovranitet dhe qeverisje). Cf. Marco Barducci, *Hugo Grotius and the Century of Revolution, 1613-1718: Transnational Reception in English Political Thought* (Oxford University Press: Oxford, 2017), fq. 69-84.

[27] **Zhan Zhak Ruso** në fakt, bënë pjesë kryesisht në autorët popullist sepse vullnetin e përgjithshëm e merr si primar, mirëpo pranon se pushteti mund të abuzohet dhe të degjenroj nëse nuk ka një ndarje të tij sipas degëve, dy sosh, siç do të shihet në vijim. Cf. Jean Jacques Rousseau, *The Social Contract Or Principles of Political Right.* Translated by G. D. H. Cole. (Constitution Society) (Original: 1762). Book III, Chapters 3-7.; Cf. më shumë edhe në Philip Pettit, "Rousseau's dilemma". Në Avi Lifschitz (ed), *Engaging with Rousseau: Reception and*

piane për ndarjen e pushtetit, megjithatë, u shfaqen vetëm me zhdukjen e rendit dhe shtetit feudal. Si një tërësi, pushtetin e përbëjnë tri degët e pushtetit: pushteti i miratimit të ligjeve apo pushteti legjislativ, pushteti i ekzekutimit të vendimeve publike apo pushteti ekzekutiv dhe pushteti i gjykimit për krimet apo lidhur me mosmarrëveshjet e subjekteve të së drejtës - judikatura apo pushteti gjyqësor. Pushteti duhet të ndahet në atë mënyrë që secila degë të ketë mundësinë e pengimit të degës apo pushtetit tjetër për të uzurpuar (përvetësuar) pushtet më shumë se që ka përcaktuar kushtetuta e ligjet e vendit, krejt kjo në funksion dhe me qëllim të ruajtjes së lirisë së individit. Në të kundërtën, siç e ka thënë **Monteskie**, çdo gjë do të prishej sikur i njëjti person apo trup i zyrtarëve, aristokratë apo njerëz të zakonshëm nga populli, të ushtronin njëkohësisht tri pushtetet.[28]

Gjatë shek. XVIII, dy rryma të mëdha janë kristalizuar lidhur me interpretimin e mendimit të **Monteskies** mbi ndarjen e pushtetit. Këto dy rryma pak a shumë reflektojnë edhe praktikën mbi ndarjen e pushteteve që u ndërtua më pastaj deri në ditët e sotme. Njëra rrymë dhe praktika e bazuar mbi të, asocohet gjerësisht me Evropën dhe juristët më shumë se me politologët dhe sheh vetëm "ndarjen e pastër të pushteteve", një ndarje e tërësishme e agjencive, funksioneve dhe personave. Tjetra rrymë asocohet kryesisht me etërit e **Kushtetutës së SHBA-së** të vitit 1787 (KAm) dhe shkrimtarët si **Benjamin Konstan** (Benjamin Constant: 1767-1830) e disa të tjerë në **Anglinë** e shekujve XVII dhe XIX, të cilët kanë parë një ndarje të pjesshme të pushtetit, përkatësisht një modifikim të doktrinës mbi ndarjen e pastër të pushtetit me sistemin e kontrollit dhe balancit.[29] Aktualisht, më afër praktikës është pikëpamja e dytë, sepse ndarja e pushtetit nuk është krejtësisht e pastër dhe absolute sepse degët e pushtetit bashkëpunojnë mes veti gjatë ushtrimit të pushtetit dhe kryerjes së punëve shtetërore. Kjo në rend të parë ka të bëj me pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv, që janë **pushtete politike**, në ndërkohë që gjyqësori është i ndarë dhe nuk bën pjesë në këtë kategori të pushtetit. Pushtetet politike ndikojnë në njëra-tjetrën në mënyrë reciproke: pushteti ekzekutiv ka të drejtën e iniciativës legjislative dhe sanksionimit, shpërndarjes së parlamentit, kurse parlamenti ka të drejtën e buxhetit, zgjedh dhe shkarkon ministrat. Ky bashkëpunim dhe ndikim reciprok i pushteteve mes vete prodhon organizimin e pushtetit të kontrolluar dhe pengon shpërdorimin e fuqisë dhe të pushtetit, përkatësisht kthimin e fuqisë në pushtet përmes përligjësimit antikushtetues e antiligjor të tij.

Të gjitha teoritë mbi ndarjen e pushtetit mund të ndahen sipas numrit të degëve të pushtetit. Mbështetur në këtë kriter, ekzistojnë tri grupe të mëdha teorish:

- teoritë dualiste;
- teoritë trialiste; dhe
- teoritë katraliste.

Teoritë dualiste dallojnë vetëm dy pushtete shtetërore: pushtetin ligjvënës dhe ekzekutiv. Në këtë kuptim, në fillim është menduar se esenca e pushtetit shtetëror konsiston në dhënien e urdhrave dhe ekzekutimin e tyre. Këto njihen si **teoritë dualiste të bazuara në mësimet e Xhon Llokut**, të përpunuara më tutje kryesisht nga **Karre de Malberg** (Raymond Carré de Malberg: 1861-1935) dhe **Hans Kelsen** (Hans Kelsen: 1881-1973), në mesin e shumë autorëve. Përfaqësues të kësaj teorie janë edhe **Xhon Llok** dhe **Zhan Zhak Ruso.** Thelbi i teorive në fjalë është ky: pushteti që jep urdhrat e natyrës së përgjithshme quhet pushtet legjislativ, kurse pushteti që ekzekuton këto rregulla të natyrës së përgjithshme

Interpretation from the Eighteenth Century to the Present (Cambridge University Press: Cambridge, 2016), fq. 168-88.

28 Baron de Montesquieue, *The Spirit of the Laws*, trans. Anne M. Cohler, Basia Carolyn Miller, and Harold Samuel Stone. Cambridge Texts in the History of Political Thought (Cambridge University Press: Cambridge, 1989) fq. 153-154.

29 Shih diskutimin e Charles Eisenmann në librin Boris Mirkine-Guetzévitch et Université de Paris - Institut de droit comparé, *La pensée politique et constitutionnelle de Montesquieu: Bicentenaire de l'Esprit des lois 1748-1948. Publié avec le concours du Centre national dé la recherche scientifique* (Recueil Siroy: Paris, 1952), fq. 135 e tutje.

quhet pushtet ekzekutiv. Dualizmi sot vështirë se mund të pranohet sepse sipas këtyre teorive edhe gjyqësori do të futej nën sqetullën e ekzekutivit, së bashku me qeverinë dhe administratën. Për këtë arsye, as nuk e diskutojmë më shumë.

Për dallim nga këto, **teoritë trialiste** ndajnë veprimtaritë (funksionet) shtetërore në ligjvënëse, ekzekutive (administrative) dhe gjyqësore. Kjo pikëpamje, aktualisht ka përkrahës më së shumti sepse, funksionin ekzekutiv e përshkruan si veprimtari që manifeston dy specifika: e para specifikë ka të bëj me **qeverinë si aspekt politik i ekzekutivit** dhe e dyta **me administratën në kuptimin e ngushtë, si një veprimtari profesionale (administrata si burokraci racionale)**.[30] Themelet e kësaj teorie i ka vënë **Monteskie**,[31] kurse më pastaj i kanë përpunuar autorët tjerë me renome, si **Paul Laband** (Paul Laband: 1838-1918), **Gjorgj Jellinek** (Georg Jellinek: 1851-1911), **Leon Digi** (Léon Duguit: 1859-1928) etj.[32] Teoritë trialiste kanë lindur si kritikë ndaj teorive dualiste, duke treguar për ekzistencën e tri degëve të pushtetit: legjislativit, ekzekutivit (administratës) dhe gjyqësorit. Te ky grupim vërehet se dallimi në mes të pushtetit ekzekutiv (administratës) dhe pushtetit gjyqësor ekziston për shkak përmbajtjes, organizimit dhe procedurës, gjë që mjafton për të konstatuar se bëhet fjalë për degë të ndryshme të pushtetit.

Shprehja ndarja e pushteteve nuk shfaqet në tekstin e veprës së Monteskies, ani pse ai thotë se liria humb nëse tri pushtete nuk janë të "ndara". Qasja e tij ndaj definimit të funksioneve të pushtetit i ngjanë rishikimit të historisë së përdorimit të tyre: kapitulli i 6 i librit XI nis me sa vijon: "Në secilën qeveri ekzistojnë tri lloje të pushtetit: legjislativ, ekzekutiv sa i përket gjërave që kanë të bëjnë me të drejtën e popujve, dhe ekzekutiv sa i përket të drejtës civile". Kjo qartë është një rithënie e ndarjes së funksioneve të pushtetit e bërë nga **Lloku**, përveç që **Monteskie** nuk përdor shprehjen "pushtet federativ" por pushtet ekzekutiv sa i përket marrëdhënieve me jashtë. Me fjalë të tjera, ai ka përqafuar, ani pse për një moment, ndarjen dualiste të funksioneve në legjislative dhe ekzekutive, aq të përhapura në shekullin XVII e më herët. Menjëherë pas kësaj ai ka sqaruar se shprehja "pushtet ekzekutiv" përdoret ekskluzivisht për të mbuluar funksionet e zyrtarëve shtetërorë për bërje të luftës dhe të paqes, pranimit dhe dërgimit të ambasadorëve, krijimit të sigurisë publike dhe përkujdesjes ndaj invadimeve. Tani Monteskie sikur nuk dëshiron të kufizojë shprehjen "pushtet ekzekutiv" në marrëdhëniet e jashtme, sepse nuk e bën të qartë nëse "pushteti për themelim të sigurisë publike" ka ndonjë konotacion të brendshëm, përkatësisht konotacion të pushtetit lokean federal, i kuptuar si pushtet ekzekutiv. Për më tepër, Monteskie shpall se do të quaj si pushtet të tretë pushtetin e gjykimit, përmes të cilit zyrtari shtetëror dënon kriminelët ose vendos mbi mosmarrëveshjet mes individëve. Kjo duket si një përpjekje për të pajtuar autoritetin e Llokut me vlerësimin e shtuar të ekzistimit të pushtetit gjyqësor si një pushtet i ndarë nga pushteti mbretëror, i cili lindi në fillimit të shekullit XVIII. Ky formulim, megjithatë, lë anash çdo llogaritje të akteve të ekzekutivit, përveç atyre që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me jashtë, sepse pushteti gjyqësor kufizohet në mosmarrëveshjet mes princit dhe individit dhe mes individëve. Me këtë, pra, **Monteskie** nuk ka arritur të pajtojë fjalorin e shekullit XVII me faktet e pushtetit dhe qeverisjes së shekullit XVIII. Me këtë dallimi mes akteve të brendshme dhe akteve të gjyqësorit është i prishur. Kur ai vazhdon tutje me përdorimin e këtyre shprehjeve, i lë mënjanë dy definimet dhe përdor ato në një kuptim më modern: tani tri pushtetet janë pushteti i nxjerrjes së ligjeve, pushteti i ekzekutimit të vendimeve publike dhe pushteti i gjykimit të çështjeve të individëve, qartë duke futur në pushtetin ekzekutiv si marrëdhëniet e brendshme ashtu edhe marrëdhëniet e jashtme. Është në kuptimi i fundit, ku Monteskie diskuton marrëdhëniet mes pushteteve shtetërore. Kjo është, në thelb, përdorimi dhe kuptimi modern i këtyre shprehjeve.

Paul Laband ka kundërshtuar modelin e Monteskies mbi pushtetet e balancuara, përmes një ndryshimi formal të konceptit kontraktues të rendit juridik, ndryshim që konsiston në avokimin e një roli ekskluziv për arsyetimin deduktiv dhe silogjistik si mënyrë e vetme për të shndërruar të drejtën në një shkencë

[30] Cf. Martin Loughlin, *Foundations of Public Law* (Oxford University Press: Oxford, 2010), fq. 438-439.
[31] Cf. më shumë në M. J. C. Vile, *Constitutionalism and the Separation of Powers,* fq. 93-95, 100-102, 105-6, 407.
[32] Ibid., fq. 268-269, 271-276.

të vërtetë. ("Wissenschaft"). Si një disiplinë akademike, e drejta duhet të konsiderohet si një aktivitet i pastër, abstrakt dhe intelektual, i liruar nga çdo brengë për ambientin e saj etik dhe social si pengesë për zhvillimin shkencor. Bota juridike e **Laband**-ut është e mbushur me urdhra juridikë të normavënësit sovran si një mjeshtër absolut, që krijon kësisoji një qeverisje të depersonalizuar të së drejtës ("Regierung der Gesetze"), e cila njeh vetëm fuqinë e detyrueshme të dispozitave të përgjithshme si një "e drejtë abstrakte e mendimit të pastër" ("die kahlen Gesetze des Denkens"). Në njërën anë, botëkuptimi i **Laband-it** i të drejtës nënkupton se qeveria mund të kërkojë çdo gjë nga qytetarët e vet mbi bazën e dispozitave me shkrim. Në këtë mënyrë, qeveria e së drejtës, jo e njerëzve, ngërthen premtimin se sundimi i së drejtës, joarbitrariteti dhe despotizmi janë standardi sjelljes. Në anën tjetër, kjo pikëpamje labandiane gjithashtu nënkupton pamundësinë e ekzistimit të të drejtave subjektive parapozitive të qytetarëve kundrejt shtetit. Është e dukshme se pozitivizmi i **Laband** është i papajtueshëm me qasjen e **Monteskies** mbi pushtetet e ndara.[33] Kundërshtimi legalistik i **Monteskies** nga **Laband** dhe të tjerët si ai mund të cilësohet si një refleksion pozitivist mbi epërsinë e legjislaturës, ashtu siç ishte supozuar më herët nga mendimtarët që i takojnë traditës kontraktaule të filozofisë politike.

Kushtetuta e Francës e Republikës së Tretë e vitit 1870 **(KFr)**, pa marrë parasysh nivelin praktik të zbatimit të saj, nuk ka mishëruar shprehimisht ndarjen e pushteteve. Juristët e kohës që kishin studiuar këtë kushtetutë dhe kishin bërë komentet e saj, si **Leon Digi**, kishin qenë të prirur për të parë në të një sistem parlamentar, të balancuar në mënyrë të duhur, ani pse më vonë u detyruan të zhvillojnë një qasje ambivalente dhe komplekse kundrejt ndarjes së pushtetit. Problemi i **Leon Digisë** ka qenë më i madh se ai që kishin ndeshur juristët e mendimtarët anglezë në të njëjtën periudhë kohore. Kjo sepse në **Francë** mbështetja liberale për pikëpamjen e **Rusosë** mbi vullnetin e përgjithshëm dhe ligjin si shprehje e tij kishte qenë tepër e fortë.[34] Kur **L. Digi** dhe juristët tjerë francezë shqyrtuan natyrën e **KFr** të vitit 1879, ata gjetën se ajo ishte një rezervuar i ideve juridike që ishin zhvilluar në **Gjermani** përgjatë një periudhe të konsiderueshme. Kanë qenë veprat e **Imanuel Kantit** (Immanuel Kant: 1724-1804), në Gjermaninë e fundit të shek. XVII, ku pikëpamja abstrakte e Rusosë mbi funksionet qeveritare gjeti shprehjen e vet më ekstreme. Tri pushtetet në shtet, kishte shkruar Kanti më 1796, mund të krahasohen me tri premisat e silogjizmit praktik, premisës sipërore, pushteti legjislativ, që nxjerr ligjet universale si shprehje të vullnetit, premisa minore, pushteti ekzekutiv, si dhënës i urdhrave në pajtim me ligjin dhe, si përfundim, pushteti gjyqësor që përmban aktgjykimin lidhur me një rast konkret. Duke çuar idenë e funksioneve të qeverisjes në skajet e saj logjik, Kanti insistonte që secili funksion të ushtrohet vetëm nga dega e duhur e pushtetit dhe secili pushtet të koordinohet me të tjerët, ngaqë ekzistojnë aq shumë persona juridikë, në ndërkohë që secili prej tyre është i nënshtruar ndaj të tjerëve, ashtu që asnjëri nuk mund t'i uzurpojë funksionet e tjetrit. Në këtë mënyrë, formulimi i Kantit i doktrinës së ndarjes së pushteteve ka qenë aq i pastër dhe aq rigid sa ka mund të jetë për kohën, mirëpo nuk ka qenë i përshtatshëm për kushtet e Gjermanisë së shek. XIX[35]

Në mënyrë paradoksale, dy karakteristikat e teorisë juridike të Gjermanisë monarkiste, theksimi i unitetit të shtetit dhe i mënyrave të dallimit të sferave të vërteta të autoritetit ligjvënës dhe administrativ, kanë qenë të përshtatshme për juristët liberalë francezë që komentonin të drejtën kushtetuese të sistemit republikan të qeverisjes në Francën e pas vitit 1870. Këtyre parimeve bazike të monarkisë kushtetuese gjermane, megjithatë, duhej shtuar një element tjetër, i nxjerr nga burime tërësisht të ndryshme mbi balancimin e pushteteve, burime qenësore për teorinë angleze të qeverisjes parlamentare. Përpjekja për të kombinuar këto koncepte të shkapërderdhura të së drejtës dhe qeverisjes u bënë nga **Leon Digi**, me pikë referimi **KFr** të vitit 1870.[36]

[33] Lukas van den Berge, "Montequieu and Judicial Review of Proportionality in Administrative Law: Rethinking the Separation of Powers in the Neoliberal Era", fq. 217-219.

[34] Shih diskutimin në Leon Duguit, "La separation des pouvoirs et l'Assemblee nationale de 1789". *Revue d'Economie Politique.* Vol. 7 No. (1893), fq. 567-615.

[35] M. J. C. Vile, *Constitutionalism and the Separation of Powers*, fq. 268, 269-270.

[36] Ibid., fq. 270-271.

Në vitin 1893, **Leon Digi** atakoi "ndarjen absolute të pushteteve", duke cilësuar si një teori artificiale të kundërt me vrojtimin shkencor të fakteve dhe e bazuar në një gabim teorik. Ai argumentoi se çdo dallim mes akteve të vullnetit shtetëror dhe vënies së këtyre akteve në jetë (zbatim) është i gabuar. Të gjitha funksionet e shtetit kërkojnë akte vullneti për implementim dhe, për pasojë, shtrojnë nevojën për manifestim të personalitetit të shtetit. Në këtë mënyrë, për ushtrimin e çdo funksioni në bashkëpunim me të gjitha organet e pushtetit është i domosdoshëm, sepse ato janë pjesë esenciale e këtij personaliteti korporatist. Qevrisja parlamentare është forma më e kënaqshme e demokracisë përfaqësuese sepse bazohet në bashkëpunim dhe solidaritet të pushteteve shtetërore, jo në ndarjen e tyre. Në regjimin parlamentar të gjitha organet e shtetit marrin pjesë në ushtrimin e një funksioni. Në këtë mënyrë Digi ka refuzuar ndarjen absolute të pushtetit, por në të njëjtën kohë ka refuzuar edhe absorbimin e krejt pushtetit në një palë duar. Për **Leon Digi-n**, ndarja e pushtetit nënkupton shpërndarjen e pushtetit shtetëror mes pjesëve të tij të ndryshme në atë mënyrë që mundëson bashkëpunimin mes tyre, në ndërkohë që veprojnë lidhur me çështjen brenda sferës së tyre. Ky koncept është e kundërta e ndarjes së pushteteve siç është zbatuar në vitin 1791, sepse për **Digi-n**, uniteti i pushtetit shtetëror jo domosdo krijon akumulimin e pushtetit në një palë duar. Duhet të ekzistojnë mjete që pengojnë absorbimin e krejt pushtetit nga një degë e pushtetit.[37]

Në fund vijnë teoritë që shohin në pushtetin shtetëror **katër funksione** (veprimtari), krahas tri funksioneve si më sipër që ushtrohen nga organet shtetërore legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore. Për mungesë të një shprehje më të mirë, këtu i cilësuam si **teori katraliste**. Funksioni i katërt është funksioni **ekzekutivo-politik**, përkatësisht funksioni i qeverisë. Përfaqësuesit e kësaj teorie mendojnë se, për dallim nga përkrahësit e teorisë trialiste, funksioni i qeverisë, përkatësisht veprimtaria ekzekutive-politike është aq specifike sa që duhet të ndahet nga tri funksionet tjera. E thënë ndryshe, këto specifika të qeverisë duhet të veçohen dhe të formojnë një funksion i veçantë, dhe jo të trajtohen si një nënlloj i pushtetit ekzekutiv, i cili përfshinë, përveç aspektit politik të qeverisë, edhe aspektin administrativ (aparati shtetëror profesional). Kjo teori ka përkrahës më të paktë në raport me teorinë trialiste. Përkrahësit e saj janë kryesisht konstitucionalistë të kohëve të vona dhe lidhen me debatet lidhur me kontekstin e lindjes dhe zhvillimit të **shtetit intervencionist** (kohës së rritjes së rolit të shtetit në shoqëri). Lindja e saj, ndërkaq, daton më herët se lindja e **shtetit intervencionist**, dhe zakonisht lidhet me gjysmën e dytë të shekullit XIX. Autori i parë përqafues i kësaj pikëpamjeje ka qenë **Benajmin Konstan**,[38] kurse më pastaj ka gjetur mbështetje te autorët tjerë si **Oto Majer** (Otto Mayer: 1846-1924), **Maris Oriu** (Maurice Hauriou: 1856-1929) etj. Një autor i mëvonshëm, autor bashkëkohor, ka thënë se është koha e fundit të thuhet "lamtumirë Monteskie", për shkak të faktit se, në përshkrimin e ndarjes së pushtetit shtetëror, **triniteti klasik** duket që është tejkaluar dhe nuk përkon me realitetin. E kemi fjalën për konstitucionalistin e mirënjohur amerikan **Brus Akerman**. Në një ese të tij të shkurtër, ky autor ka theksuar se, në vend të insistimit në ndarjen klasike të pushteteve, "[...] ne duhet të ndryshojmë qëndrim dhe të shohim botën institucionale në të cilën institucionet e pavarura çdo ditë e më shumë luajnë rol dhe ushtrojnë funksione të rëndësishme, ani pse ato nuk mund të klasifikohen si legjislaturë, ekzekutivë apo gjyqësor. Triniteti i shenjtë […] na inkurajon që të shpërfillim (injorojmë) dinamikat e ndryshme që udhëheqin operacionet administrative në regjimet parlamentare dhe presidenciale".[39]

Teoritë katraliste, përveç legjislativit e gjyqësorit, bëjnë edhe ndarjen mes pushtetit ekzekutiv dhe administrativ. Pushteti ekzekutiv ka dimensionin politik sepse nxjerr akte politike (aktet e qeverisë), kurse administrata kryen punë tekniko-profesionale si pjesë e ekzekutimit dhe zbatimit të akteve

[37] M. J. C. Vile, *Constitutionalism and the Separation of Powers*, fq. 272.

[38] **B. Konstan** ka ndarë në mënyrë të rreptë pushtetin mbretëror nga pushteti ekzekutiv: sipas tij ekzistojnë katër pushtete, pushteti ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor dhe, së fundi, pushteti mbretëror. Ky i fundit, pushteti mbretëror, ishte pushtet neutral dhe i ndërmjetëm që shërbente si balancues i tri pushteteve të tjera me qëllim të ruajtjes së harmonisë në mes tyre. Cf. më shumë në Ibid., fq. 94, 224-226.

[39] Bruce Ackerman, "Good-bye, Montesquieu". Në Susan Rose-Ackerman and Peter L. Lindseth (eds), *Comparative Administrative Law* (Edward Elgar: UK and USA, 2010), fq. 128-133 në fq. 131.

të përgjithshme. Në këtë frymë, **B. Konstan** ka ndarë në mënyrë të rreptë pushtetin mbretëror nga pushteti ekzekutiv: sipas tij ekzistojnë katër pushtete, pushteti ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor dhe, së fundi, pushteti mbretëror. Ky i fundit, pushteti mbretëror, ishte pushtet neutral dhe i ndërmjetëm që shërbente si balancues i tri pushteteve të tjera me qëllim të ruajtjes së harmonisë në mes tyre.[40] Duke pasur parasysh gjendjen e konstitucionalizmit në fund të shekullit XIX deri në periudhën pas Luftës së Parë Botërore, **Oto Majer** ka thënë se **e drejta kushtetuese** ishte në zhdukje e sipër, si pasojë e rolit **intervencionist të shtetit**, në ndërkohë që **e drejta administrative** me sukses kishte mbijetuar triumfalisht pikërisht si rezultat i rolit në rritje të shtetit në shoqëri. Sipas tij, **e drejta kushtetuese**, nuk kishte asnjë punë tjetër pos përcaktimit të sferës së veprimit administrativ të shtetit dhe garantimit të saj me kushtetutë. Ekzekutimi i mëpastajmë i rolit kushtetues të shtetit, gjithnjë sipas tij, ngelet në dorë dhe mëshirë të shtetit intervencionist.[41]

Në një **demokraci parlamentare**, thotë **Oriu**, duhet të ketë dominim të ekzekutivit ndaj legjislativit, duke besuar se kjo është mënyra më e mirë për të ruajtur shtetin; kjo epërsi e ekzekutivit ndaj legjislativit bëhet në mënyrën më të mirë përmes kufizimi të rolit të parlamentit vetëm në deliberim dhe kontroll, jo në ligjvënie e përfaqësim; gjyqet janë të zhvlerësuara në konceptin e tij mbi shtetin, i cili është tërësisht shtet administrativ, në të cilin pajtimi i lirisë dhe pushtetit kryhet përmes bërjes së rendit, i cili krijohet vetëm nëse populli përkrah veprimet që burojnë nga ekzekutivi; kjo përkrahje çdo herë është spontane, kurse forca ushtrohet vetëm përjashtimisht kur duhet mbajtur dëgjueshmërinë e atyre që janë në pakicë; në këtë kuptim, rregullat kushtetuese nuk janë asgjë pos rregulla, kurse esenca e tyre qëndron në institucionin e shtetit si tërësi e gjallë dhe si paraqitje strukturore e shoqërisë, kurse pushteti ekzekutiv shërben si një koncentrues i refleksioneve dhe vullneteve individuale; ky mendim është formësuar nën ndikimin e fuqishëm të dy revolucioneve, Francez dhe Industrial, dhe rritjes së borgjezisë dhe ndërmarrësisë së saj që ka shkaktuar nevojën për ndërhyrje të shtetit si mbrojtës apo instrument i kësaj borgjezie nga fundi i shekullit XIX dhe në mes të dy luftërave botërore.[42]

Të shumta janë kritikat ndaj parimit të ndarjes së pushtetit. Për pikënisje kanë ideologji të ndryshme. Fundja, vetë teoria për ndarjen dhe baraspeshën e pushtetit ka origjinën e vet në ideologjinë liberale të borgjezisë së re që po kërkonte rrugë e arsye për të përmbysur rendin feudal në të cilin origjina e pushtetit shtetëror ishte hyjnore dhe, për pasojë, binte ndesh me çdo teori ose ide mbi ndarjen e tij. Sipas teorisë dhe praktikës mbi shtetin feudal, meqë pushteti ishte hyjnor, atëherë as nuk mund të ndahej sepse e kishte titullarin e përcaktuar nga vetë hyjnia. Kjo shpjegon faktin se përse kritikat e para ndaj parimit të ndarjes së pushtetit kanë origjinë në ideologjitë e të djathtës reaksionare konservative, totalitarizmit, oligarkisë, elitizmit, të cilat e kanë parë si shkak të dobësimit të shtetit, shtetit të dobët dhe të pafuqishëm. Një pjesë tjetër e kritikave niset nga pandashmëria e pushtetit sepse, siç e thonë këta kritikë, sovraniteti popullor është i pandashëm dhe organi përfaqësues i popullit, trupi përfaqësues (parlamenti), si organ demokratik, duhet të ketë pozitën më të lartë në hierarki.

---

40 Cf. më shumë në M. J. C. Vile, *Constitutionalism and the Separation of Powers*, fq. 94, 224-226.

41 Cf. më shumë në Blake Emerson, *The Public's Law: Origins and Architecture of Progressive Democracy* (Oxford University Press: Oxford, 2019), fq. 48; Pablo Ruiz-Tagle, *Five Republics and One Tradition: A History of Constitutionalism in Chile 1810-2020* (Cambridge University Press: Cambridge, 2021), fq. 113 (në kontekstin e origjinës së përvojave me intervenimet e shtetit në Kili përgjatë historisë, përfshirë diktaturat ushtarake, zë në gojë dhe shtjellon edhe pikëpamjet e Oto Majer); Cf. gjithashtu edhe Martin Loughlin, *Foundations of Public Law*, fq. 439, 443.

42 Cf. më shumë në MAURICE HAURIOU, *PRÉCIS DE DROIT ADMINISTRATIF CONTENANT LE DROIT PUBLIC ET LE DROIT ADMINISTRATIF* (LIBRAIRIE DU RECUEIL GÉNÉRAL DES LOIS ET ARRÊTS: Paris, 1893) fq. 5- 20, 21-25; MAURICE HAURIOU, *PRÉCIS ÉLÉMENTAIRE DE DROIT CONSTITUTIONNEL*. DEUXIEME ÉDITION (LIBRAIRIE DU RECUEIL SIREY: Paris, 1930), fq. 122-123; Christopher B. Gray, *The Methodology of Maurice Hauriou: Legal, Sociological, Philosophical* (Rodopi: Amsterdam, New York, NY: 2010) fq 1-44; Julien Barroche, "Maurice Hauriou (1856–1929)". Në Olivier Descamps and Rafael Domingo *(eds.), Great Christian Jurists in French History* (Cambridge University Press: Cambridge, 2019), fq. 342-357 në fq. 354-356.

Në botën bashkëkohore çdo ditë e më shumë ka ardhur deri te përqafimi i parimit të ndarjes së pushtetit, formë e pushtetit shtetëror, përkundër që në asnjë shtet nuk është vënë në jetë në formën e tij të pastër, ashtu siç e ka paramenduar **Monteskie**. Mes organeve të pushtetit shtetëror ekziston ndarja por edhe bashkëpunimi, ndikimi dhe kontrolli reciprok në kushte konkrete shoqërore, që ndikon në moszbatimin në mënyrë të njëjtë në shtete të ndryshme të parimit të ndarjes së pushtetit. **Parimi i unitetit të pushtetit** nuk është shtjelluar aq shumë teorikisht, krahasuar me parimin e ndarjes së pushtetit, por as në praktikë nuk ka pasur një jetë të gjatë, gjë që ka bërë që të ngelet nën hijen e parimit të ndarjes së pushtetit. Parimi i unitetit (koncentrimit) të pushtetit nënkupton bashkimin e funksioneve shtetërore nën ombrellën e organit legjislativ ose ekzekutiv. Bashkimi konsekuent i funksioneve shtetërore nënkupton **unitet absolut të pushtetit**, me sundimtarin si titullar të vetëm të të gjitha funksioneve dhe organet tjera si ushtrues të pushtetit në emër të tij. Kjo ka qenë karakteristikë e shteteve skllavopronare, monarkive absolute të feudalizmit, kalifateve. E kundërta e kësaj, ndërkaq, është **uniteti relativ i pushtetit** dhe haset në një numër të vogël të shteteve moderne, ku një organ është më i larti dhe ka të drejta të konsiderueshme kundruall bartësve të tjerë të funksioneve shtetërore - të drejtën e zgjedhjes, shkarkimit, kontrollit, dhënies së urdhrave dhe udhëzimeve.

Uniteti demokratik i pushtetit përfaqëson një variant të unitetit të pushtetit në të cilin organi më i lartë, organi përfaqësues, si dhe vetë sistemi i pushtetit, quhet **sistemi i kuvendeve**. E kundërta e tij është **uniteti jodemokratik i pushtetit**, që ekziston atëherë kur organi më i lartë nuk është organi përfaqësues por ekzekutivi, që ka formën e shefit të shtetit, liderit ose të komitetit (një trup ekzekutiv kolektiv). Në këto sisteme ka ekzistuar legjislativi, por ka qenë në tërësi i nënshtruar ndaj ekzekutivit. E njëjta gjë ka ndodhur me gjykatat. Në këto vende kushtetuta ekziston formalisht, por qeveriset në bazë të karizmës së liderit, komunikimit të tij të drejtpërdrejtë me popullin dhe përkrahjes së supozuar plebishitare nga populli. Në këto futen sistemet autoritare ose sistemet diktatoriale, siç kanë qenë regjimi i **Pinoçetit** (Augusto José Ramón Pinochet Ugarte: 1915-2006) në **Kili**, nga viti 1973 deri në vitin 1981, i **Frankos** (Francisco Franco: 1892-1975) në **Spanjë** nga viti 1939-1975 dhe, si forma jodemokratike, regjimet totalitare naziste e fashiste në **Gjermani** dhe **Itali** (1933-1945)

Përtej shtjellimeve teorike lidhur me organizimin e pushtetit, në shtetet moderne dallohen disa lloje të funksioneve (pushteteve, veprimtarive) shtetërore, që kanë nevojë për klasifikim. Si kriter për identifikimin e tyre merret përmbajtja e veprimtarisë shtetërore me të cilën shteti përmbush qëllimet dhe synimet e veta. Mbi këtë bazë mund të dallohen **ligjvënia** (apo pushteti **kushtetutëvënies** dhe **ligjvënies**), **ekzekutivi** (apo **pushteti ekzekutiv-politik** dhe **pushteti ekzekutiv-administrativ**) dhe **gjyqësia**. **Ligjvënia** ka lindur si rezultat i nevojës së shtetit modern, në përpjekjet e tij për të depersonalizuar marrëdhëniet e pushtetit, për të rregulluar marrëdhëniet e komplikuara shoqërore përmes normave abstrakte. Shfaqja e marrëdhënieve ekonomike të tregut dhe forcimi i këtyre marrëdhënieve ka imponuar nevojën për siguri juridike dhe llogaridhënien për aktet e ndërmarra gjatë afarizmit. Liria, prona, siguria dhe të drejtat e tjera të njeriut kanë nënkuptuar se duhet të ekzistojnë rregulla të përgjithshme dhe të qarta, paraprakisht të miratuara. Ato rregulla duhet të garantojnë krijimin e një qeverie të përgjegjshme dhe të moderuar por, në të njëjtën kohë, edhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të ndërmarrësve privat dhe qytetarëve. Rregullat zakonore nuk kanë mund të plotësojnë këto kërkesa për siguri juridike. Pikërisht për këtë arsye, në shtetin modern, në veçanti pas revolucioneve në **Amerikë** dhe **Francë** në fund të shekullit XVIII, rregullat e përgjithshme i miraton organi përfaqësues që njihet me emrin e përgjithshëm parlament (kongres, kuvend, sejem, sabor, kneset dhe të ngjashme, në vartësi të gjuhës nacionale). Në të njëjtën kohë, parlamenti paraqitet si organ shtetëror me disa autorizime të rëndësishme dhe me efekt konstituiv ndaj organeve të tjera shtetërore. Detyrë themelore e këtij organi shtetëror ngelet miratimi i vendimeve më të larta politike dhe juridike (më së shumti në formë të ligjeve dhe, kohë pas kohe, edhe në formë të teksteve kushtetuese), me të cilat në mënyrë të përgjithshme rregullohen marrëdhëniet më të rëndësishme politike, ekonomike,

kulturore dhe të tjera. Menjëherë pasi në **Amerikë** u krijua dallimi në mes të ligjit të lartë dhe ligjit të ulët përkatësisht në mes të kushtetutës dhe ligjit të zakonshëm, ndarja në fjalë u bë e zakonshme dhe u bë pjesë e pandashme e teorisë dhe praktikës kushtetuese evropiane. Zakonisht organi përfaqësues miraton edhe kushtetutën edhe ligjet tjera, por sipas procedurave të ndryshme për secilën prej tyre. Ekzistojnë edhe praktika kushtetuese kur miratimi i kushtetutës dhe rishikimi i saj bëhen nga një organ i veçantë kushtetutëbër**ës** (misioni i të cilit përfundon me miratimin e kushtetutës), si dhe raste kur kërkohet miratimi i propozimit të kushtetutës së miratuar nga parlamenti në një referendum popullor, por edhe praktika që kombinojnë këto forma. Ajo që duhet të mbahet mend këtu është se pushteti (funksioni apo veprimtaria) ligjvënës i përcakton themelet e rregullimit politik dhe juridik të shoqërisë së tërësishme, përmes krijimit të normave kushtetuese dhe ligjore.

Normat e përgjithshme që krijon parlamenti duhet të realizohen në jetën shoqërore. Në këtë drejtim veprojnë **ekzekutivi** dhe **gjyqësori**. Të parin e përbëjnë një sërë organesh shtetërore me kompetenca të ndryshme, gjë që e bën definimin e saj të vështirë. Për këtë arsye, ekzekutivi shpesh definohet si veprimtari shtetërore që nuk i takon ligjvënies dhe gjyqësorit. Ky definim negativ nuk sugjerohet. Më shumë preferohet numërimi i cilësive të ekzekutivit si mënyrë për definimin e tij. Në këtë aspekt, pikë së pari preferohet që të bëhet dallimi në mes të nënllojeve të ekzekutivit (disa autorë këto nuk i cilësojnë si nënlloje, por si veprimtari apo pushtete të posaçme shtetërore). Nënfunksioni i parë i ekzekutivit është **qeveria** apo **veprimtaria ekzekutivo-politike**. Këtë nënfunksion e kryejnë, në vartësi nga organizimi i pushtetit në disa vende, shefi i shtetit apo i qeverisë (përkatësisht edhe shefi i shtetit edhe qeveria në sistemet e përziera). Këto organe paraqiten, në të njëjtën kohë, si organe ekzekutive kundrejt organit kushtetues-ligjor dhe si organe të vendimmarrjes politike kundrejt administratës shtetërore. Për këtë arsye, në kompetencën e tyre hyjnë punët e ekzekutimit të ligjit ("nënligjvënia"), koordinimi dhe udhëheqja e administratës, udhëheqja me politikën e jashtme, planifikimi i politikës së përgjithshme dhe nxjerrja e akteve politike ("aktet e qeverisë").

Aktet juridike që i sjellin këto organe (qeveria dhe shefi i shtetit; ky i fundit mund të jetë president i republikës, monark, princ, dukë, arqipeshkv etj.) nuk kanë formën e tyre të posaçme, gjë që shërben si një arsye e fortë dhe kryesore për mosfutjen e tyre në rubrikën e funksionit (pushtetit apo veprimtarisë) të katërt shtetëror të posaçëm. Për dallim prej këtij nënlloji ekzekutivo-politik të ekzekutivit, **administrata** sjell aktet konkrete juridike dhe ndërmerr veprime materiale në vijim të zbatimit të dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore. Kjo nënkupton se administrata është veprimtari më e ulët shtetërore, jo vetëm në raport me ligjvënien por edhe kundrejt funksionit të qeverisë. Përveç kësaj, administrata sipas nevojës ekzekuton edhe vendimet gjyqësore (me rastin e ekzekutimit të institucionit të privimit të lirisë) dhe ndërmerr veprime të caktuara materiale (më rastin e konfiskimit të pasurisë apo dëbimin e dhunshëm nga banesa të personit të futur në të në mënyrë të kundërligjshme, mbajtjen e rendit gjatë seancave gjyqësore e kështu me radhë).

Forma e tretë e veprimtarisë (funksionit apo pushtetit) shtetëror është **gjyqësia.** Me këtë veprimtari sigurohet mbajtja dhe realizimi i rendit juridik, në veçanti garantohet mbrojtja e të drejtave dhe lirive të garantuara kushtetuese. Veprimtaria gjyqësore i jep vlerë rendit juridik në rastet individuale, kurse esenca e funksionit konsiston në vlerësimin e sjelljeve njerëzore sipas masës (parametrave) së normës juridike e me qëllim të vendosjes së rasteve konkrete dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në shoqëri. Këto të fundit lindin në mes të qytetarëve dhe subjekteve të tjerë të së drejtës private, në mes të tyre dhe organeve shtetërore dhe, së fundi, në mes vetë organeve shtetërore. Këto raste e mosmarrëveshje krijohen çdo herë kur subjektet e së drejtës nuk pajtohen lidhur me të drejtat dhe detyrimet reciproke që kanë në rendin juridik si dhe lidhur me kuptimin e saktë të normave të caktuara. Në rastet e krijimit të rastit apo mosmarrëveshjes juridike, rendet juridike bashkëkohore ua ndalojnë subjekteve të së drejtës ushtrimin e **vetëgjyqësisë** për realizimin e të drejtave që u takojnë sipas rendit juridik. U mor vesh, rendi juridik nuk ua ndalojnë palëve që në mënyrë paqësore të zgjidhin rastet dhe mosmarrëveshjet që kanë. Mirëpo, nëse një tentim i tillë për zgjidhjen paqësore të rastit apo mosmarrëveshjes dështohet si

jo me efekt, atëherë duhet t'i drejtohen gjyqit. Për më tepër, ekzistojnë raste kur palët mund të zgjidhin vetë mosmarrëveshjen apo rastin e lindur, por gjykatat prapëseprapë duhet të prononcohet lidhur me kuptimin e normës. Këtë e bën me vendim meritor, me të cilin interpreton kuptimin e normës, pa marrë parasysh pëlqimin e palëve. Si shembull tipik i kësaj është legjislacioni penal, i cili përcakton detyrimin për ndjekje penale të kryesve të veprave të rënda penale (aktakuzën e ngrit prokurori publik, si një lloj i veçantë i organit të drejtësisë).

Edhe pse veprimtaria gjyqësore ka të bëj me zbatimin e një normë të përgjithshme në një rast apo mosmarrëveshje konkrete, veprimtaria e tillë nuk është mekanike. Papërcaktueshmëria e gjuhës dhe abstraksioni i kuptimeve juridike i japin gjyqësorit një shkallë lirie me rastin e zbatimit të normës së përgjithshme në një rast konkret. Për këtë arsye, gjyqtari nuk paraqet vetëm një individ që shqipton symbyllur fjalët e ligjit, siç ka thënë dhe besuar **Monteskie**, pa asnjë mendim vetjak lidhur me kuptimin e normës që zbaton.[43] Arsyeja për këtë mendim të **Monteskies** duhet kërkuar në gjendjen me gjyqësorin në kohën e dinastisë **Burbon** (Dinastia Burbon: 1589-1793) para vitit 1789. Në këtë kohë, ai ka qenë një vegël e verbët e realizimit të vullnetit të mbretit dhe në tërësi i korruptuar, duke punuar me anime dhe ryshfet. Për këtë arsye, në vitin 1789, në **Francë** instalohet ideja për supremacinë e vullnetit të përgjithshëm të organit përfaqësues dhe ligjvënës, duke ia lënë gjyqësorit një rol krejtësisht teknik dhe mekanik për zbatim në raste konkrete të këtij vullneti të përgjithshëm. Kjo, megjithatë, me kohë është parë se nuk mund të jetë e realizueshme ashtu që në fund të shekullit XIX e tutje edhe Franca i bashkohet vendeve të tjera në të cilat gjyqësori përveç që zbaton normën në një rast apo mosmarrëveshje konkrete përmes interpretimit gjyqësor, ai bën edhe zhvillimin kreativ të frymës së saj të përgjithshme.[44]

Përveç gjykimit të rasteve dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, roli i gjyqësorit është i pashmangshëm edhe në mbrojtjen e **lirive dhe të drejtave** të garantuara kushtetuese. Parimi i sundimit të së drejtës dhe shtetit juridik nuk mund të ndërtohet pa një gjyqësi të pavarur. Pavarësia e gjyqësorit ka për qëllim të siguroj që gjyqtarët të jenë mbi dhe përtej makinerisë së pushteteve të tjera. E drejta duhet të ndahet nga politika, kurse gjyqtarëve duhet t'u sigurohet që të kryejnë punët e tyre vetëm në bazë të kushtetutës, ligjit dhe akteve nënligjore. Askush nuk ka të drejtë të ndikoj në atë se si duhet gjyqtari të zbatoj një normë të përgjithshme në një rast apo mosmarrëveshje konkrete. Për të arritur këtë, në sistemet bashkëkohore juridike kultivohet me ngulm parimi i përhershmërisë në punë të gjyqtarëve dhe moslëvizjes së tyre nga vendet e punës, përveç rasteve të përcaktuara me kushtetutë e ligj. Në anën tjetër, me qëllim të mbrojtjes së parimit të ligjshmërisë dhe ruajtjes e mbrojtjes së paanshme dhe efektive të lirive dhe të drejtave të njeriut, përcaktohet e drejta për ankesë dhe mjete të tjera juridike. Përveç kësaj, me qëllim të mbikëqyrjes së punës së gjyqësorit është ndërtuar transparenca e gjykimit, përveç përjashtimeve të përcaktuara me ligj. Një faktor me rëndësi që garanton pavarësinë e gjyqësorit është edhe përzgjedhja e gjyqtarëve, që zakonisht bëhet nga mesi i juristëve të diplomuar me provim të dhënë të jurisprudencës. Përzgjedhjen e bëjnë trupat e veçantë jashtë kontrollit politik, **këshillat gjyqësor** apo trupat ekuivalent me to. Zgjedhja e gjyqtarëve nga parlamentet çdo ditë e më shumë po bëhet praktikë e rrallë, në veçanti kur bëhet fjalë për vendet ish-komuniste.[45] Ndër vendet e demokracive të vjetra, **Britania e Madhe** dikur ka pasur në gjirin e parlamentit instancën më të lartë gjyqësore, praktikë që është braktisur me formimin Gjykatën

[43] U mor vesh, sot gjyqtarët janë krijues të elementit të caktuar normativ për shkak se me vendimet e tyre meritore shqiptohet sanksioni për persona të caktuar, kur konstatohet se kanë kryer vepër penale, nuk kanë zbatuar detyrimin kontraktues dhe detyrime të tjera që kanë pasur dhe kështu me radhë. Cf. më shumë për këtë në K. M. Schonfeld, "Un jeu de patience: Montesquieu, la bouche et le silence de la loi "*Revue du Nord*. Tome 52, No. 204 (Janvier-mars 1970) fq. 137-138.

[44] Cf. më shumë për këtë në Enver Hasani & Muhamet Brahimi, *Gjyqësia kushtetuese* (Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina": Prishtinë, 2021) fq. 40-44.

[45] Cf. më gjerësisht në Roderick A. Maçdonald and Hoi Kong, "Judicial Independence as a Constitutional Virtue ". Në Michel Rosenfeld and András Sajó (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law* (Oxford University Press: Oxford, 2012) fq. 831-858; Daniel Smilov, "The Judiciary: The Least Dangerous Branch?". Në Michel Rosenfeld and András Sajó (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law*, fq. 859-873.

Supreme në vitin 2009, si një instancë e veçantë që ka fjalën e fundit në të gjitha çështjet gjyqësore, përfshirë çështjet kushtetuese. Gjithashtu, në gjirin e këtyre demokracive ekziston një praktikë e gjatë për caktim të gjyqtarëve nga ekzekutivi, por që nuk dëmton parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve si pasojë e kulturës së lartë juridike që mbizotëron në këto vende (kryesisht vendet skandinave).[46] **Në** mënyrë të ngjashme, në **Francë** pas vitit 1789, gjyqësori ngeli anash për një kohë sepse u konsiderua si i kompromet uar nga regjimi i vjetër. Për këtë u vunë themelet e gjyqësisë administrative, që u personifikua me institucionin e **Këshillit të Shtetit** ("Conseil d'État"), i cili, megjithatë, sot e kësaj dite nuk konsiderohet si gjykatë apo gjyqësor, por më shumë si një drejtësi administrative në kuptim të gjykimit mbi ligjshmërinë e punës së agjencive dhe institucioneve të pavarura që lindën si pasojë e ngritjes dhe fuqizimit të shtetit administrativ, për çka flasim në nënseksionin në vijim, dhe ndarjes së administratës si burokraci nga pjesa politike e ekzekutivit.[47]

1.3. Sistemet e pushtetit

Shtetet ndërtojnë sisteme të ndryshme të pushtetit që bazohen në ndarjen ose unitetin e pushtetit. **Sistemi presidencial** bazohet në ndarjen konsekuente dhe mund të thuhet të ngurtë, të pushtetit, sipas shembullit të sistemit të krijuar në **SHBA**. Sistemi parlamentar është i ndërtuar mbi ndarjen e pushtetit, ku bashkëpunimi dhe ndërvarshmëria mes legjislativit dhe ekzekutivit është më e madhe dhe më intensive sesa në sistemin presidencial. Ky bashkëpunim vërehet si në punët e përditshme të udhëheqjes me shtetin, ashtu edhe me rastin e zgjedhjes së titullarëve (bartësve) të tri pushteteve. Sistemi origjinal parlamentar i **Britanisë së Madhe** ka qenë model i ndërtimit të parlamentarizmit klasik në shtetet tjera. Shtet tipik me sistem të ndryshuar parlamentar është **Franca.** Ky sistem quhet **gjysmëpresidencial** apo **sistem i përzier** i pushtetit. Këtë term e ka farkëtuar **Mauris Diverzher** (**Maurice Duverger: 1917-2014**). Quhet i përzier sepse në sistemin parlamentar janë futur elementet e sistemit presidencial, duke u nisur nga zgjedhja e drejtpërdrejtë e presidentit dhe deri te kompetencat e theksuara ekzekutive të këtij institucioni.

Për të gjitha sistemet tjera të ndarjes së pushtetit shtetëror mund të thuhet se krijohen duke u bazuar në njërin prej sistemeve të sipërcekura, por megjithatë modelohen dhe ndërtohen nën ndikimin e kushteve specifike që kanë të bëjnë me traditën politike dhe kulturën juridike vetjake. Këto specifika i largojnë nga burimi e modeli origjinal, duke i bërë sistemet e tilla aq të veçanta sa të mos mund të futen në grupet e sistemeve presidenciale ose parlamentare që kanë shërbyer si model për ndërtimin e tyre.

1.3.1. Sistemi presidencial

Sistemi presidencial është formë e ndarjes së pushtetit në të cilin në mënyrë të qartë e të dukshme janë të ndara tri pushtetet shtetërore: ligjvënia, ekzekutivi dhe gjyqësori. Secila prej këtyre degëve të pushtetit ushtron kompetencat e veta në mënyrë të pavarur dhe qëndron, aq sa është e mundur në të vërtetë, si e barabartë kundrejt dy degëve të tjera të pushtetit. Në shtetin e parë në të cilin është zbatuar kjo ndarje kaq e pastër e pushtetit, në **SHBA**, degët e pushtetit në të njëjtën kohë shërbejnë si fre dhe baraspeshë ("checks and balances") kundruall njëri- tjetrit. Kjo nënkupton që njëra degë e pushtetit nuk lejon që tjetra të del nga kuadri i përcaktuar kushtetues dhe të keqpërdor pushtetin dhe as të fitoj (grumbulloj) sasi të tepërt të pushtetit dhe fuqisë politike. Ky sistem në të vërtetë është model teorik e normativ që në praktikë bën që presidenti, si pushtet ekzekutiv, udhëheq me shtetin,

[46] Susan Rose-Ackerman, "The Regulatory State". Në Michel Rosenfeld and András Sajó (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law* fq. 671-, 685; Jeffrey Goldsworthy, "Constitutional Interpretation". Në Michel Rosenfeld and András Sajó (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law*, fq 689-717 (në këto dy shkrime tregohet tradita e demokracive tradicionale për caktimin e gjyqtarëve nga ekzekutivi, por sipas një konsensusi që rezulton pa problem për shkak të kulturës juridike të etabluar me dekada në vendet skandinave).

[47] Martin Loughlin, *Foundations of Public Law*, fq. 439; M. J. C. Vile, *Constitutionalism and the Separation of Powers*, fq. 259, 268.

por jo në mënyrë të pakontrolluar dhe as në kurriz të kompetencave që i takojnë ligjvënësit e gjyqësorit.

Duke u treguar i suksesshëm në **SHBA**, sistemi presidencial ka shërbyer si model për shtetet e zonës së ndikimit amerikan - vendet e **Amerikës Latine**, pastaj disa **shtete afrikane** (Bregu i Fildishtë, **Çadi**, Liberia etj.), **aziatike** (Filipinet, Indonezia etj.), kurse në **Evropë** nuk ekziston asnjë vend që e ka përqafuar (më i afërt me të është sistemi **Qipros**). U mor vesh, këtu nuk futen sistemet "presidenciale" të **Bjellorusisë**, **Turqisë**, të cilat janë antipod i sistemit presidencial të ndarjes dhe balancimit të pushtetit shtetëror: thjeshtë, këtu bëhet fjalë për dy vende me regjime autokratike politike që me kushtetutë e kanë të sanksionuar koncentrimin e pushtetit në duart e shefit të shtetit në kurriz të degëve të tjera të pushtetit. Në Evropë shtetet më së shpeshti kanë futur në parlamentarizmin e tyre disa elemente të sistemit presidencial, duke ndërtuar kësisoj **sistem specifik të përzier** i pushtetit. Gjatë zbatimit nga vendet tjera, sistemi presidencial është deformuar në një presidentcializëm duke ndërtuar pushtete autoritare. Me këtë është zvogëluar kompetenca e parlamentit, kompetencat e presidentit janë zgjeruar, fuqia e ushtrisë është rritur, krejt kjo në kurriz të ndarjes së pushtetit.

KAm ka përfqafuar dhe përpunuar një formë në të cilën ekzekutivi është në duart e presidentit, legjislativi i takon **Kongresit**, kurse pushteti gjyqësor **Gjykatës Supreme** (GJSAm). Pushteti ekzekutiv është më së shumti aktiv, udhëheq me shtetin dhe përcakton politikën shtetërore, kurse i takon vetëm një individi - **Presidentit të SHBA**-ve, një organi individual si bartës i vetëm i pushtetit ekzekutiv monist. U mor vesh, në praktikë presidenti SHBA-ve këtë punë nuk mund ta kryej vetë, por bashkërisht me sekretarët që i emëron dhe me zëvendëspresidentin e SHBA-së që zgjidhet së bashku me të. Ky i fundit kryen vetëm punët që ia beson presidenti, kurse sekretarët, që janë 15 dhe të ngjashëm me ministrat e qeverisë, i përgjigjen vetëm presidentit për udhëheqje me resorët përkatës. Njëri nga ta ka pozitën e sekretarit të shtetit dhe është, në fakt, sekretari për Punë të Jashtme. Sekretarët nuk përbëjnë organ të posaçëm të pushtetit siç është rasti me qeverinë në një sistem parlamentar, as nuk kanë autorizime origjinale, por janë të lidhur ndërmjet veti përmes presidentit në emër të të cilit punojnë dhe të cilit i përgjigjen.

Sipas nenit II të **KAm**, presidentin e zgjedhin qytetarët thelbësisht në mënyrë të drejtpërdrejtë, përkundër që kjo mënyrë votimi nuk është e formalizuar sepse qytetarët zgjedhin elektorët (zgjedhësit), të cilët në **kolegjin elektoral**, duke përcjellë vullnetin e qytetarëve, votojnë për kandidatët për president. Mandati i presidentit është katër vite, me mundësi rikandidimi dhe zgjedhjeje edhe një herë dhe fillon me dhënien e betimit para kryetarit të **GJSAm**. Kjo, çdo herë bëhet më datën 24 janar. Me kufizimin në dy mandate, largohet mundësia që një organ kaq i rëndësishëm e me ndikim të fitojë (mbledh) fuqi të madhe politike e të bëhet autokrat. Zgjedhja e drejtpërdrejtë mundëson që presidenti të realizojë lidhjen direkte me sovranitetin popullor dhe të mbetet në këtë mënyrë në nivelin e njëjtë me organin legjislativ, Kongresin e SHBA-së.

Në jetën reale, presidenti është larg tjerëve organi më i dalluar – ai është shef shteti, komandant i forcave të armatosura, shefi i pushtetit të tërësishëm ekzekutiv dhe administratës ("qeverisë" dhe administratës, përkatësisht pjesës politike dhe jo politike të ekzekutivit). Presidenti **nuk ka të drejtë të propozoj ligje**, por këtë e bën në rrugë joformale, përmes fjalimit vjetor mbi gjendjen e kombit, që paraqet programin e tij ligjvënës, si dhe tërthorazi përmes kongresmenëve nga partia e vet politike. Në përfundim të procedurës së ligjvënies, presidenti shpall ligjin, por edhe mund të vë veto në të, duke kthyer në Kongres për rivotim ose mund ta suspendojë (pezullojë) në tërësi të njëjtin (e aq "vetoja e xhepit" ose "pocket veto"). Një e drejtë veçanërisht me ndikim është ajo e nxjerrjes së **urdhrave ekzekutivë** ("exceutive orders"), që praktikisht kanë fuqinë e ligjit dhe, për pasojë, mohojnë ndarjen kushtetuese të pushtetit.

Sipas nenit I të **KAm**, **Kongresi** përbëhet nga dy dhoma, **Dhomës së përfaqësuesve** (435 anëtarë) dhe Senatit (100 anëtarë), të cilët i zgjedhin qytetarët në njësi federale. Në ushtrimin e pushtetit legjislativ, dhomat janë të barabarta. Politikisht, megjithatë, **Senati** është më me ndikim, për çka flet fakti se senatorët kanë mandat gjashtëvjeçar, kurse mandati i kongresmenëve, Dhomës së Ulët të **Kongresit**, është dy vite. Kongresi pjesërisht ndikon në punën e presidentit në çështjet e kuadrove dhe politikën e jashtme: Senati jep pëlqimin për caktimin e funksionerëve dhe miraton lidhjen e traktateve ndërkombëtare. Ndikimi i Kongresit në presidentin është i madh ose i vogël, në vartësi të asaj nëse partia e tij politike ka shumicën në **Kongres** ose është në opozitë. Përveç kësaj, **Kongresi** miraton buxhetin dhe ka të drejtë ta shkarkojë presidentin në formë publike të gjykimit politik, i njohur si **impeachement**. Në gjuhën shqipe ky institucion nuk mund të përkthehet ndryshe pos në mënyrë përshkruese, si një proces **hetimi** që mund të çoj **shkarkim** të një zyrtari të lartë apo të një zyrtari që ka përgjegjësi të rëndësishme shtetërore.

Imeachment-i është proces përmes të cilit legjislatura mund të ngre akuza kundër një zyrtari shtetëror për sjellje të keqe që mund të çoj në shkarkim nga detyra të të njëjtit. **Imeachment**-i gjithashtu mund të ndodh në nivel të shteteve anëtare, nëse një gjë e tillë përcaktohet me dispozitat e tyre kushtetuese. **Impeachment**-i kalon nëpër dy dhomat e Kongresit. Dhoma e Përfaqësuesve mund të nis **imeachment**-in kundër një zyrtari federal me një shumicë të thjeshtë të anëtarëve që janë prezentë apo sipas kritereve të tjera konform nenit I, seksioni 2, klauzola 5, nenit I, seksioni 3, klauzolat 6 dhe 7, neni II, seksionet 2 dhe 4 të **KAm**.[48] Kjo rezulton në nisjen e gjykimit për **imeachment**, i cili me një votë prej dy të tretave (2/3) mund të dënoj një zyrtar, duke shkarkuar nga detyra. Senati mund të votoj, vetëm me shumicë të thjeshtë, për të ndaluar personin e dënuar në **imeachment** nga ushtrimi i funksionit federal në të ardhmen. Shumica e shteteve mund të ushtrojnë **imeachment**, përfshirë guvernatorin, në pajtim me kushtetutat e shteteve të tyre. Për më tepër, kjo procedurë parashihet edhe për strukturat qeverisëse të fiseve amerikane. Procedurat e **imeachment**-it, për nga natyra e tyre më shumë janë shëruese ("remedial") sesa ndëshkuese, për shkak se krejt procedura synon largimin nga zyra të zyrtarit që ka bërë shkelje serioze të ligjit. Meqë procesi nuk është ndëshkues, pala që ka kaluar **imeachment**-in mund të jetë subjekt i gjykimit penal ose civil, akuzimit dhe dënimit sipas ligjit pas shkarkimit nga zyra. Gjithashtu, për shkak se dënimi në **imeachment** nuk është ndëshkim, presidenti i **SHBA-së** përjashtohet kushtetutshmërisht nga falja personit të dënuar me impeachment. Kjo për shkak se pasojat juridike të impeachment-it nuk mund të shlyhen me falje.

Në nivel federal, procesi **impeachment**-it zakonisht përbëhet prej procedurave trishkallëshe. Faza e parë është hetimi për **impeachment**, e cila nuk duhet të ndiqet medoemos. Dy faza kushtetuese që kërkohen për shkarkim janë **impeachment**-i nga Dhoma e Përfaqësuesve dhe gjykimi në Senat. Thënë me fjalë të tjera, së pari nis hetimi nga Dhoma e Përfaqësuesve. Së dyti, Dhoma e Përfaqësuesve, me një shumicë të thjeshtë të atyre që janë prezentë dhe votojnë, nxjerr nenet e **impeachment** ("articles of impeachement"), që janë pretendime formale ose pretendim formal. Kjo në fakt është e ngjashme me aktakuzën. Me kalimin e neneve në fjalë, konsiderohet se ka nisur **impeachment**-i.

---

[48] Neni I, seksioni 2, klauzola 5 e **KAm** përcakton: "Dhoma e Përfaqësuesve zgjedh kryetarin dhe zyrtarët tjerë dhe ka krejt pushtetin e **impeachment**-it".
Neni I, seksioni 2, klauzolat 6 dhe 7 të **KAm** përcakton: "Senati ka pushtetin për gjykim të krejt rasteve të **impeachment**-it. Kur vepron në atë cilësi, atëherë këtë e bën nën betim. Kur gjykohet presidenti **SHBA**, kryetari **GJSAm** kryeson gjykimin dhe askush nuk mund të shpallet fajtor nëse votojnë për këtë dy të tretat e atyre që janë prezentë. Aktgjykimi në rastet e **impeachment**-it nuk shtrihet përtej largimit nga detyra apo shkarkimi dhe skualifikimi nga mbajtja e çdo zyre nderi, besim ose përfitim në SHBA; por pala e gjetur fajtore mund të jetë subjekt i akuzës, gjykimit, aktgjykimit dhe ndëshkimit penal, sipas ligjit".
Neni II, seksioni 2 i KAm përcakton: "Presidenti [...] do të këtë autorizim për dhënien e lëmoshës dhe faljeve për veprat kundër SHBA-së, përveç në rastet e **impeachment**".
Neni II, seksioni 4 i KAm përcakton: "Presidenti, zëvendëspresidenti dhe krejt zyrtarët civilë të SHBA-së, shkarkohen ose largohen nga zyra me **impeachment** për shkak të dënimit për tradhti, korrupsion dhe krime të tjera të rënda dhe kundërvajtje".

Në fazën e tretë, Senati gjykon të akuzuarin. Nëse bëhet fjalë për **impeachment**-in e presidentit të **SHBA**-ve, atëherë procedurat e gjykimit në Senat i udhëheq kryetari i **GJSAm**. Për **impeachment**-in e çdo zyrtari tjetër, **KAm** është e heshtur për sa i përket asaj se kush duhet të kryesoj procedurat, duke sugjeruar ky rol mund t'i takoj presidentit të Senatit, që është zëvendëspresidenti i SHBA-së. Dënimi ose gjetja fajtor në Senat kërkon një shumicë prej dy të tretave të atyre që janë prezentë. Pasojë e dënimit ose gjetjes fajtor është largimi nga zyra dhe (si opsion me një votim të ndarë) skualifikimi nga mbajtja e çfarëdo zyre federale në të ardhmen, që kërkon votën e shumicës së senatorëve prezentë.

Në maje të pushtetit gjyqësor është **GJSAm** (neni III i **KAm**), që përbëhet nga kryetari, formalisht personi i dytë në shtet pas **Presidentit të SHBA-së**, dhe tetë gjyqtarë, të gjithë me mandat të përjetshëm përderisa sillen mirë ("during good behaviour"). I emëron presidenti i **SHBA-së**, me pëlqimin e Senatit dhe duke iu përmbajtur kritereve politike dhe juridike, përkatësisht partiake. **GJSAm** nuk është vetëm organ i pushtetit gjyqësor, gjykatë e shkallës së fundit, por posedon edhe një rol shumë të rëndësishëm politik dhe autoritet për interpretim të **KAm**. Me autorizimin për të treguar në një kontest kushtetues konkret se çka është kushtetuese e çka jo, **GJSAm** praktikisht pandërprerë e ndryshon atë. Qëndrimi i saj nëse një akt ose veprim i organeve të tjera është në pajtim më **KAm**, kontrolli i kushtetutshmërisë, vështirë mund të dallohet nga politika, gjë që bën që pushteti gjyqësor të ketë fjalën e fundit në çështjet shtetërore. E parë nga ky kënd, **GJSAm** paraqet atë gojëzën që frenon pushtetet tjera politike. E, megjithatë, për shkak të mënyrës së punës dhe organizimit, **GJSAm** nuk mund të jetë një pushtet që udhëheq me shtetin – ai mund të jetë vetëm pushteti ekzekutiv, përkundër faktit që flitet për fuqinë mbizotëruese të **GJSAm** në këtë sistem të pushtetit. Këtë legjitimitet të **GJSAm**, të cilin ajo vetë e ka ndërtuar që nga rasti i njohur **Marbury v. Madison** (1803), kur përvetësoi të drejtën për të ushtruar kontrollin gjyqësor të kushtetutshmërisë, nuk e ndajnë një pjesë bukur e madhe e gjyqësorit të ulët. Kjo është kështu sepse pushteti gjyqësor fiton pjesërisht legjitimitetin e vet nga populli: gjyqtarët e disa gjykatave nëpër njësi federale zgjidhen sikur kandidatët partiakë dhe jopartiakë që zgjidhen nga populli, në mbi 20 shtete anëtare të **SHBA-së** (Alabama, Illinois, Pensilvania, Teksasi etj). Kjo është një specifikë tjetër e pushtetit gjyqësor në **SHBA**.

1.3.2. Sistemi parlamentar

Ekziston një vlerësim i përgjithshëm, sipas të cilit, në sistemin parlamentar nuk është bërë ndarja konsekuente e pushteteve si në **sistemin presidencial.** Në vend të ndarjes, në sistemin parlamentar theksi në fakt vihet te bashkëpunimi mes degëve të organizuara të pushtetit, në rend të parë mes legjislativit e ekzekutivit. Në kuptimin abstrakt, sistemi parlamentar është më pak demokratik se sistemi presidencial. Kjo është kështu për arsye se, në sistemin klasik parlamentar, qytetarët zgjedhin vetëm pushtetin ligjvënës, në ndërkohë që në sistemin presidencial zgjidhet edhe ekzekutivi dhe, pjesërisht edhe gjyqësori.

Parlamentarizmi, megjithatë, nuk është sistem i unitetit të pushtetit. Ai ngërthen në vete shumë variante të formës fillestare të parlamentarizmit, i cili ka lindur në **Angli**, duke ikur nga forma e vet fillestare. Ky parlamentarizm i ndryshuar, pra që i ka ikur modelit origjinal që ka lindur në **Angli**, ka pasur sukses më së shumti në Evropë dhe në disa vende të tjera dhe njihet me emrin **sistemi i përzier** apo **sistemi francez** i pushtetit. Karakteristikat themelore të sistemeve parlamentare konsistojnë në sa vijon: qeveria formohet nga shumica parlamentare, është politikisht përgjegjëse para parlamentit dhe i nënshtrohet kontrollit të tij dhe, në anën tjetër, qeveria së bashku me shefin e shtetit mund të shpërndajnë parlamentin. Kjo mund të çoj në përfundimin se legjislativi dhe ekzekutivi kanë pozitë dhe ndikim të njëjtë politik në sistem. Por, kjo nuk është kështu: në praktikë është ekzekutivi ai që mbizotëron, udhëheqë me politikën dhe drejton shtetin.

Sistemin parlamentar e karakterizon **pushteti ekzekutiv bicefal** (me dy koka), njëra koka e shefit të shtetit dhe tjetra koka e qeverisë (ekzekutivi). Është pikërisht raporti i forcave politike dhe pozita kushtetuese mes këtyre dy organeve, ato që bëjnë dallimin themelor mes **parlamentarizmit klasik** dhe

sistemit parlamentar të përzier. Megjithatë, epërsia e shefit të shtetit ose qeverisë brenda pushtetit ekzekutiv nuk është vetëm prodhim i normave kushtetuese, por edhe i rrethanave të tjera konkrete politike, siç janë: statusi i bartësve të pushtetit në partinë politike në pushtet, vetë autoriteti i bartësve të pushtetit, tradita, zakonet, marrëdhënia e parlamentit me zgjedhësit etj.

Sistemi klasik parlamentar, në **Angli** është ndërtuar me shekuj, në mënyrë evolutive, kurse rrënjët e tij shtrihen deri në **Mesjetë** te **Karta e Madhe e Lirive** ("Magna Carta Libertatum: 1215"), e cila ka kufizuar pushtetin e monarkut (kurorës), deri te shpushtetëzimi i vërtetë i shefit të shtetit, që aktualisht ekziston në Britaninë e Madhe. Ky sistem njihet gjerësisht si **sistemi i Uestministerit** ("Westminster System"). Në sistemin klasik, qeveria ka pushtetin ekzekutiv, kurse përmes shumicës së vet në parlament praktikisht drejton edhe me pushtetin ligjvënës, që e bën atë superior politikisht. Karakteristikë e sistemit zgjedhor britanik është se prodhon dy parti të mëdha politike që ndërrohen në pushtet, duke krijuar, sipas rregullit, një qeveri homogjene njëpartiake. Partia e dytë politike sipas fuqisë, nganjëherë edhe e treta, formon "qeverinë nën hije" ("Shadow Cabinet"), si një zëvendësim joformal (alternativë) e qeverisë ekzistuese në pushtet.

Qeveria është bartëse e pushtetit ekzekutiv, e përbëjnë ministri i parë apo kryeministri dhe ministrat. Kabineti qeveritar si një trup kolegjial përbëhet nga resorë kryesorë, përkatësisht ministra (21 deri 23 anëtarë), dhe është bartës i pushtetit të vërtetë ekzekutiv. Në veçanti theksohet pozita e ministrit të parë, kryeministrit, që është njëkohësisht edhe lider i partisë politike në pushtet. Qeveria sipas rregullit është njëpartiake e vetëm përjashtimisht qeveri e koalicionit (ta zëmë, gjatë kohës së luftës), kështu që praktikisht nuk ekziston instituti i votimit të mosbesimit ndaj qeverisë nga ana e parlamentit. Në të njëjtën kohë, anëtarët e qeverisë janë anëtarë të parlamentit, që flet për atë se dy organet gjenden në kontroll reciprok të drejtpërdrejtë.

Qeveria duhet të gëzoj besimin e shumicës parlamentare, përkatësisht vetëm besimin e **Dhomës së përfaqësuesve** ("House of Commons"). Kjo supozohet me rastin e krijimit të qeverisë, ashtu që ajo as nuk votohet në këtë dhomë. Në anën tjetër, nëse qeverisë i votohet mosbesimi, me kërkesë të opozitës, apo vetë qeveria kërkon votëbesim, atëherë ajo nuk ka detyrim të tërhiqet nga pushteti, por këtë e bën prapëseprapë shkaku i presionit të opinionit publik. Përgjegjësia politike e qeverisë para parlamentit vërehet me rastin e dorëheqjes së qeverisë, që më së shpeshti çon në shpërndarjen e parlamentit. Koka e dytë e pushtetit ekzekutiv është shefi i shtetit, monarku, që nuk ka pushtet real. Ai politikisht vepron sipas asaj që i thotë qeveria. Çdo akt i shefit të shtetit duhet të kundërfirmoset nga ana e kryeministrit, ministrit të resorit ose krejt qeveria. Me kundërfirmën apo bashkëfirmosjen, shefi i shtetit lirohet formalisht nga përgjegjësia politike, meqë edhe ashtu në realitet nuk ushtron pushtet ekzekutiv.

Bartës i pushtetit ligjvënës është **parlamenti dydhomësh**. Dhoma e ultë gati në tërësi ushtron kompetencat e parlamentit, kurse **Dhoma e lartë** ("House of Lords") është një organ që në disa raste ka të drejtën e vetos suspenzive në aktet e Dhomës së ulët. Qeveria është propozues i ligjeve dhe i vendimeve më të rëndësishme politike që miratohen në parlament, sepse, në fakt, ajo është shumicë qeveritare në Dhomën e ulët.

Sistemi i përzier i pushtetit është model i parlamentarizmit që më së shpeshti lidhet me **KFr** të vitit 1958. Ekziston edhe në Austri, Finlandë, Portugali, Poloni, Serbi etj. Sistemet e përziera e kanë përpunuar variantin e vjetër të parlamentarizmit francez të përcaktuar me **Kushtetutën e vitit 1875**, në të cilin shefi i shtetit ka qenë pushtet aktiv ekzekutiv, qeveria (Këshilli ministror) është dashur të ketë përkrahjen permanente të Asamblesë nacionale, kurse vetë funksioni ministrit dhe i deputetit kanë qenë të papajtueshëm. Në **sistemin e përzier**, qeveritë janë kryesisht qeveri koalicionesh, shpesh jostabile për shkak të sistemit zgjedhor dhe skenës partiake në përgjithësi, kurse qeveria duhet të jep dorëheqje kur votohet mocioni mosbesimit ndaj saj apo kur vetë vlerëson se ka humb besimin e shumicës në parlament.

Sistemi i sotëm i përzier francez ka futur elemente të sistemit presidencial dhe është larguar nga parlamentarizmi klasik. Brenda pushtetit ekzekutiv gjithashtu ekzistojnë dy koka, mirëpo presidenti është pushteti më i fuqishëm. Presidenti zgjidhet drejtpërdrejtë nga ana e qytetarëve (element ky i sistemit presidencial, kurse katet e tij nuk janë të kushtëzuara nga kundërfirma e qeverisë ose ministrave të resorit). Presidenti është shef autoritativ i pushtetit ekzekutiv dhe kryeson mbledhjet e Këshillit Ministror, por aktet e tij, përveç atyre që shprehimisht përmenden në **KFr**, i nënshkruan kryeministri dhe, në raste të caktuara, edhe ministrat përgjegjës të resorit.

Qeveria është nën hijen e shefit të shtetit dhe politikisht e fuqishme aq sa është vetë koalicioni që e mbështetë atë. Qeveria brenda pushtetit ekzekutiv fuqizohet në veçanti në periudhat e njohura si "kohabitim" (bashkëjetesë nën një kulm, por jo me vullnet), që krijohet atëherë kur shefi i shtetit drejtpërdrejt i zgjedhur dhe qeveria nuk janë të së njëjtës parti apo opsion politik.

Edhe në sistemin e përzier parlamenti është në vijën zbritëse të fuqisë politike në raport me pushtetin ekzekutiv. Ai është trup ligjvënës që numrin më të madh të ligjeve dhe vendimeve politike i miraton me propozim të pushtetit ekzekutiv dhe kësisoj, në realitet, zbaton politikën dhe vullnetin e ekzekutivit. Kësaj duhet shtuar edhe ajo që parlamenti delegon, i bartë ekzekutivit të drejtën për të sjellë ligje, që përcaktohet edhe me vetë **KFr** (edhe të vendeve të tjera që kanë sistem të njëjtë të pushtetit sikur Franca).

Pushteti gjyqësor në sistemin parlamentar është i pavarur dhe i ndarë nga pushteti ligjvënës dhe ekzekutiv. Nuk ekziston ndonjë dallim thelbësor në raport me pozitën e gjyqësorit në sistemin presidencial.

1.3.3. Sistemi i kuvendeve

Sistemin e kuvendeve e karakterizon bartësi i njëjtë i pushtetit ligjvënës dhe ekzekutiv - kuvendi, ndaj të cilit organet tjera shtetërore nuk kanë asnjë autorizim. Pozita e veçantë dhe e privilegjuar e kuvendit nënkupton që organet tjera nuk mund të marrin pjesë së bashku me të në ushtrimin e funksionit normativ, nuk kanë veto dhe nuk mund të ndryshojnë aktet e saj, as nuk kanë instrumente (mjete) për ndikim faktit në të. Sistemi i pushtetit ku me shtetin udhëheq një trup i madh dhe me shumë dallime, siç është kuvendi, vështirë se mund të mbijetojë në kushtet reale shoqërore. Për këtë arsye ky sistem as që ka ekzistuar ndonjëherë veçse në format e tij fillestare, por as në aspektin teorik nuk ka parë ndonjë shtjellim serioz e sistematik ndër shekuj. Ky sistem, thjesht, nuk ka pasur ndonjë sukses të dalluar, sepse për drejtim të shtetit kërkohet një grup më homogjen dhe më i vogël i njerëzve me kompetencë profesionale.
Uniteti i pushtetit në këtë sistem vërehet në atë se bartës i pushtetit ekzekutiv, funksionit ekzekutiv, është në të vërtetë vetë një organ i kuvendit: këshilli ekzekutiv (komision, këshill, por ka edhe emra të tjerë), nga ajo që bën i ngjan qeverisë në sistemin parlamentar, por pozita e tij në raport me organin përfaqësues është shumë më e dobët. Këtu nuk ka marrëdhënie të kontrollit e baraspeshës reciproke, sepse organi ekzekutiv nuk mund të shpërndaj kuvendin, të kërkoj besimin e tij, të kërcënojë me paraqitjen e dorëheqjes apo tërheqjen e vet. Edhe në këtë sistem pushteti gjyqësor është i ndarë formalisht, por në kohë lufte e revolucione ka qenë e nënshtruar ndaj kuvendit dhe organeve të saj. Edhe në kohë paqeje në këtë sistem, gjyqësori ka pasur pavarësinë e cunguar sepse gjyqtarët dhe aspektet tjera të organizimit të gjyqësorit janë vendosur nga kuvendi.

Shembulli i parë i sistemit të kuvendeve ka qenë në **Revolucionin francez** të vitit 1878. Atëherë qe formuar **Konventa nacionale** ("Convention nationale"), si kuvend i popullit, si një organ ligjvënës dhe drejtues, pjesë e së cilës ka qenë pushteti ekzekutiv me ministrat që në të vërtetë ishin delegatë dhe nëpunës të Konventës. **KFr** e vitit 1793 ka konstitucionalizuar këtë sistem të Konventës, por vetë ajo asnjëherë nuk u zbatua. Kohë pas kohe, Konventa ka ushtruar edhe funksionin gjyqësor. Sistemi kuvendeve më pastaj, për një kohë të shkurtër, është përsëritur gjatë kohës së **Komunës së Parisit**, përkatësisht 72 ditë gjatë vitit 1871, kur krejt pushteti u përmbledh në një organ që quhej **Komiteti i shpëtimit kombëtar**. Sistemi i kuvendeve në **Evropë** ka ekzistuar në ish-vendet komuniste deri në fund të shek.

XX, si në **Bashkimin Sovjetik**, **Hungari**, **Jugosllavi**, **Poloni**, **Shqipëri** etj. Sot një sistem i përshtatur i kuvendeve ekziston në **Zvicër**, krejtësisht me një përmbajtje tjetër nga ai i vendeve ish-komuniste.

Sistemi zviceran i kuvendeve quhet "sistemi direktoratit", sipas modelit të **KFr** të vitit 1795, ku funksionin e shefit të shtetit e ushtron pjesërisht presidenti i direktorartit (Këshillit federal), pjesërisht ushtrohet në mënyrë kolegjiale nga vetë direktorati. Ky sistem i unitetit të pushtetit, megjithatë, është i përcaktuar në bazë të pozitës kushtetuese të Këshillit federal ("Bundesrat"/"Conseil federal"), i cili është bartës i pushtetit ekzekutiv dhe organ suprem drejtues i **Konfederatës së Zvicrës**. Në këtë sistem, Këshilli Federal nuk mund të shpërndaj Kuvendin Federal ("Bundesversammlung"/"Assemblee federale"), të ngreh çështjen e besimit të vet, dhe duhet të pranoj dhe zbatoj vendimet e Kuvendit. Këshilli federal, megjithatë, është organ që nuk mund të revokohet dhe që drejton shtetin falë rrethanave siç janë: jetëgjatësia e sistemit politik, stabiliteti i përbërjes politike të Këshillit, profesionalizmi i anëtarëve, ndërlidhshmëria me aparatin administrativ të shtetit. Krejt këto bëjnë që nënshtrimi i tij ndaj Kuvendit as mos të shtrohet si çështje.

2. Parlamenti

2.1. Emri dhe prejardhja e parlamentit

Parlamenti është organ i pushtetit ligjvënës, trupit që nxjerr ligje. Në parlament flitet (lat.: **parlare** – flas), diskutohet, debatohet dhe votohet mbi propozimin e ligjeve ose aktit tjetër juridik. Ndër ne është përvetësuar emri kuvend, një emër foljor me të cilin shprehet një aktivitet njerëzor që quhet kuvendim në traditën shqiptare dhe të popujve të tjerë. Pra nuk është vend ku ka fjalim e debat por kuvendim, deliberacion, apo shqyrtim për diçka, lidhur me një temë apo subjekt. Emri **parlament**, megjithatë, është emërues i përbashkët në të gjitha kulturat dhe popujt, pa marrë parasysh regjimin dhe derivon nga tradita angleze. U mor vesh, specifikat gjuhësore të secilit popull përcaktojnë përdorimin e emrave përkatës me të cilët përshkruhet institucioni i njëjtë. Kështu, ta zëmë, në Islandë, parlamenti quhet **Althing**, në Suedi - **Riksdag**, në Danimarkë - **Folketing**, në Finlandë - **Eduskunta**, në Norvegji – **Stortinget**, në Izrael - **Kneset**, në Turqi – **Mexhlis** dhe kështu me radhë.

Origjina e organit të pushtetit ligjvënës nga vullneti i të cilit varet zgjedhja, puna dhe shkarkimi i qeverisë apo organit që ushtron pushtetin ekzekutiv, duhet të kërkohet në trajtat zhvillimore të parlamentit anglez, i cili, megjithatë, nuk është organi më i vjetër që vazhdon të jetoj në kontinuitet: sipas burimeve të tjera të studiuesve të historisë së të drejtës kushtetuese, ai organ është **Alting**-u islandez, i themeluar nga ardhacakët norvegjezë dhe ekziston që nga viti 930, me ndërprerje të vogla prej vetëm 45 ditëve në shekullin XIX. Arsyeja pse origjina e parlamentit në kuptimin si më sipër duhet të kërkohet në Angli ka të bëjë me atë se, parlamenti anglez në mënyrë graduale ka fituar kompetencat që ka sot trupi përfaqësues si i tillë. Në të vërtetë, mbi parlamentin bashkëkohor mund të bëhet fjalë vetëm nga koha e lindjes së borgjezisë, pas rënies së feudalizmit dhe largimit të aristokracisë, e cila mori frerët e pushtetit në shtetet e ndryshme evropiane. Si pikënisje kohore për këtë ndryshim, përkatësisht për largim të aristokracisë dhe marrjes së pushtetit nga borgjezia merret Revolucioni i Francës (1789-1799).

Sikundër u tha, **parlamenti anglez** është bërë organi më i lartë i pushtetit, juridikisht i pakufizuar, në një mënyrë graduale dhe përgjatë shekujve. Në një periudhë të caktuar historike, nga fillimi i vitit 13, aristokracia, e bashkuar në një formë të kuvendit të aristokracisë, ka ngritur ndaj monarkut kërkesën për të marrë pjesë në vendimmarrje me rastin e përcaktimit të tatimit. Një herë i detyruar të caktoj tatimin vetëm me mbështetjen e aristokracisë së lartë, përmes **Kartës së Madhe të Lirive**, sundimtari më nuk ka pasur mundësi të zhbëjë këtë gjendje. Pararendësit e parlamentit anglez kanë qenë trupat e ndryshëm të aristokracisë dhe pasanikëve të tjerë të mëdhenj, të cilët ia kanë kufizuar në mënyrë graduale pushtetin e pakufizuar në origjinë të kurorës.

Para pushtimit norman të **Anglisë** në vitin 1066, trupi këshillëdhënës që ka qëndruar pranë kurorës ose përkundër saj, ka qenë **këshilli i të urtëve**, i njohur si "The Witan", një shprehje kjo e krijuar në kohën viktoriane të **Britanisë së Madhe** (1837-1901).[49] Ky trup përbëhej nga magnatë kryesorë, fetar dhe laik, që kishte funksion parësor të këshillonin mbretin për çështje të ndryshme, siç ishin: shpallja e ligjeve, aktgjykimet e gjyqeve, miratimin e kartave për transferin e tokës, zgjidhjen e mosmarrëveshjes, zgjedhja e peshkopëve dhe kryepeshkopëve dhe çështje të tjera të rëndësisë së madhe në nivel vendi. Këshilli gjithashtu ka pasur detyrim të miratoj caktimin e mbretit të ri. Anëtarësia në të përbëhej nga fisnikët më të rëndësishëm dhe klerin e lartë, dhe takohej së paku një herë në vit, në vende të ndryshme të Anglisë. Pas pushtimit norman, mbreti i parë i këtij pushtimi, **Uilliami I i Anglisë** (William I of England: 1028-1087), eliminoi këshillin e të urtëve, duke zëvendësuar atë me **curia regis** (oborri apo këshilli mbretëror; ang.: "Royal Council"). Ky trup ishte organi më i lartë qeverisës që kryente punët e shtetit, qoftë të karakterit legjislativ, gjyqësor apo diplomatik.[50] Anëtarë të saj ishin kryefeudalët (baronët, peshkopët dhe abatët), së bashku me zyrtarët e lartë të shtetit dhe të oborrit mbretëror (sekretarët, kryeoficerët, financierët, mareshalët etj.). Të gjithë zyrtarët e lartë të shtetit dhe të oborrit mbretëror, me raste të caktuara, thirreshin nga mbreti së bashku dhe kjo u quajt **Këshilli i Lartë** ("Magnum Concilium"), dhe cili kishte rol këshillëdhënës, por edhe të drejtën për të vendosur mbi tatimet (nga viti 1215). Nga fundi i shek. XIII, ky këshill ka shërbyer si shembull i parlamentit, që me kohë bëhet organ dydhomësh. Pas **Revolucionit Madhërishëm** (1688), organi deriatëhershëm kryesor ligjvënës, parlamenti, fiton epërsi ndaj mbretit.

Parlamenti anglez, tani Parlamenti i Britanisë së Madhe, është organ ligjvënës, i cili, si organ i sovranitetit nacional, bazohet në supozimin mbi pakufizueshmërinë e tij juridike. Konceptin mbi epërsinë e tillë të parlamentit, i pari e ka ndërtuar konstitucionalisti britanik, **Albert Dajs** (Albert Venn Dicey: 1835-1922). Ky ka argumentuar se Parlamenti britanik është një legjislaturë absolutisht sovrane, që ka të drejtën për të bërë dhe zhbërë ligjet. Në librin e tij monumental mbi të drejtën kushtetuese britanike, ai ka definuar të drejtën kushtetuese si tërësi që përfshinë të gjitha rregullat që drejtpërdrejt ose tërthorazi afektojnë distribuimin apo ushtrimin e pushtetit sovran brenda shtetit. Për të liria e shtetasve britanikë varet nga sovraniteti i parlamentit, paanësia e gjyqeve të lira nga ndërhyrja e pushtetit dhe nga supremacia e të drejtës së përgjithshme.[51] Autorë të tjerë kanë thënë të njëjtën gjë më pastaj. Kështu, ta zëmë, politologu nga Gjeneva, **Zhan Lui de Lolm** (Jean-Louis de Lolme: 1740-1806) ka dhënë mendimin e famshëm se parlamenti mund të bëjë çdo gjë, përveç shndërrimit të burrit në grua dhe gruas në burrë.[52] Kjo reflekton atë që e ka theksuar **Ajvor Xheningz** (Sir William Ivor Jennings: 1903-1965) kur në vitin 1959 ka ripërsëritur tezën e tij se parlamenti është vetë kushtetuta.[53] U mor vesh, në kohët e sotme parlamenti nuk posedon kompetenca të pakufizuara sipas modelit fillestar anglez. Tani thuajse të gjitha shtetet kanë kushtetuta të shkruara që në mënyrë të qartë përcaktojnë kufizimet dhe parametrat e sovranitetit të këtij organi kushtetues. E thënë ndryshe, për dallim nga koncepti origjinal i parlamentit në Britanisë e Madhe, organi bashkëkohor ligjvënës qëndron nën kushtetutën e shkruar, i kufizuar me norma dhe parime kushtetuese.

Përveç kompetencave financiare në sferën e tatimeve dhe atyre gjyqësore, parlamenti fiton pushtetin ligjvënës me kushtetutat e para të shkruara që kodifikojnë materien kushtetuese në një mënyrë maksimalisht gjithëpërfshirëse. Deputetët më nuk janë përfaqësues të shtresave të caktuara, por të krejt popullit. Kuvendet e shtresave që kishin sunduar përgjatë shekujve kishin sjellë **Revolucionin Francez**, që e

[49] Geoffrey Hindley, *A Brief History of the Anglo-Saxons* (Robinson: London, 2006), fq. 220.

[50] Adams, George Burton Adams, "The Descendants of the Curia Regis". *The American Historical Review* Vol. 13 Issue 1 (October 1907), fq. 11–15, në fq. 12.

[51] Cf. më shumë në Albert V. Dicey, *Introduction to the Study of the Law of the Constitution* (8 ed.) (Macmillan: London, 2015), pjesa e parë: "Sovraniteti i Parlamentit".

[52] Cf. më shumë në Jean-Louis de Lolme, David Lieberman (ed.), *The Constitution of England* (Liberty Fund: Indianapolis, Ind., 2007).

[53] William Ivor Jennings, *The Law and the Constitution*, 5th edn (University of London Press: London, 1959), fq. 314. Ky libër për herë të parë është botuar në vitin 1934.

bëri borgjezia si shtresë e re, e cila shpalli shtresën e vet së cilës i takonte, **shtresën e tretë**, si **Asamble Nacionale**. Këtë koncept, pra që shtresa e tretë, që identifikohej kryesisht me shtresën e përgjithshme dhe me borgjezinë, e krijoj abati **Sies** (Emmanuel-Joseph Sieyès Abbé Sieyès: 1748-1836), njëri ndër ideologët më të rëndësishëm të Revolucionit Francez. I shkruar në vigjilje të këtij revolucioni, pamfleti ka çuar në revolucion legal, që nis më 5 maj 1789, kur tri shtresat (aristokracia, kleri dhe borgjezia) u takuan në Versajë. Ky takim u shndërrua në asamble, ku borgjezia shpalli veten përfaqësuese të krejt popullit, duke pohuar se jo vetëm që kishte të drejtë për ndihmë dhe këshillim të kurorës, por edhe se vetë ajo ishte titullari dhe mbajtësi i vetëm sovranitetit. Ai, pra populli dhe borgjezia si shtresë që fliste në emër të tij, përfaqësonte çdo gjë, ngaqë ishte bartës i vetëm i sovranitetit, dhe asnjëherë kurora mbretërore. Ky pozicion ishte i jashtëzakonshëm për kohën, nga shkaku se u formua për qëllimet e rithemelimit të monarkisë, duke përmbysur origjinën hyjnore të pushtetit dhe duke e kthyer këtë origjinë të popullit, si burim i vetëm legjitim i pushtetit politik. Pas 17 qershorit 1789, veçanërisht pas betimit për unitet me popullin të borgjezisë dhe të një pjese të klerit, i bërë tri ditë më vonë, më 20 qershor, Asambleja Nacionale, që përfaqësonte shtresat e gjëra popullore, apo popullin e përgjithshëm, shpalli veten Asamble Konstitutive, më 9 korrik, para shpërthimit të revolucionit popullor që ndodhi më 13 dhe 14 korrik të po atij viti. Në këtë vepër pamflet, **Sies** paraqet dhe kritikon situatën e momentit, para shpërthimit të revolucionit në fjalë dhe tregon për reformat që duheshin bërë, në veçanti ajo që vota e secilit rend shoqëror të ishte në proporcion me përfaqësuesit e tyre realë që kishin në popull, sepse ishte e qartë që shtresa e tretë, populli i përfaqësuar nga borgjezia, përfaqësonte 98 % të krejt kombit francez.[54] Kjo përfaqëson lajmërimin për themelimin e asamblesë nacionale konstitutive në Francë, për herë të parë në historinë kushtetuese evropiane. Ideja themelore e Asamblesë nacionale konsistonte në atë se, sikur edhe sot, parlamenti miraton ligje që janë shprehje e vullnetit politik të krejt popullit, që ishte krejt ndryshe nga situata kur këto akte juridike, por edhe kushtetutën, i prodhonte kurora. Në këto raste nuk kishte liri për të gjithë, sepse kurora dhe zyrtarët e saj mbanin në duart e tyre të gjitha pushtetet.

Vetëm formalisht parlamenti udhëheq me procedurën e ligjvënies, sepse në të vërtetë ai zakonisht bën atë çfarë që propozon ekzekutivi. Deri në **Luftën e Parë Botërore**, parlamenti është konsideruar institucion politik qendror, për të humbur këtë primat në favor të pushtetit ekzekutiv nga kjo kohë e tutje dhe në mënyrë graduale. Arsyet e depushtetëzimit të parlamentit kanë qenë të shumta. Në njërën anë, ato kanë të bëjnë me vetë parlamentin, siç është fakti i ngadalësimit në vendimmarrje, procedurës së komplikuar të punës, shqyrtimit popullist nëpër komisione dhe seanca plenare, në vend të një shqyrtimi profesional nga ekspertët. Në anën tjetër, janë të një natyre krejtësisht tjetër arsyet e depushtetëzimit të parlamentit, që shkaktohen nga ndryshimi i karakterit të shtetit. Në shtetin modern marrëdhënia kryesore politike është marrëdhënia mes partive në pushtet dhe atyre në opozitë, jo mes parlamentit dhe ekzekutivit. Në këtë mes, një rol kolosal e luan opinioni publik, faktor që ka ardhur duke u fuqizuar nga koha mes dy luftërave botërore çdo herë e më shumë, aq sa tani puna e pushtetit kontrollohet më shumë nga opinioni publik sesa nga parlamenti. Kjo është arsyeja pse ekzekutivi pandërprerë, sipas rregullit, komunikon me mediat dhe provon forcërisht të ndikoj te votuesit dhe opinioni i gjerë publik. Edhe ndryshimi i mënyrës së zgjedhjes së shefit të shtetit, i shoqëruar me ndryshime rrënjësore në menynë e kompetencave nga ato ceremoniale e formale në vendimmarrje ekzekutive dhe të vetme të këtij organi kushtetues. Kjo bën që parlamenti të humb rëndësinë e organit të vetëm që zgjidhet nga populli.

2.2. Zgjedhja, struktura, përbërja, legjitimiteti dhe madhësia e parlamentit

Parlamentin e zgjedhin drejtpërdrejtë qytetarët. Votuesit janë qytetarë me të drejta të barabarta të votës, të ndarë në disa njësi zgjedhore, zgjedhja me një njësi zgjedhore është dukuri më e rrallë kushtetuese. E njëjta vlen edhe për strukturën njëdhomëshe të parlamentit, që është me e shpeshtë se zgjidhjet kushtetuese të parlamenteve me dy e më shumë dhoma. Qytetarët me votim e bartin sovranitetin e tyre në parlament, përkatësisht në parlamentin si tërësi.

[54] Cf. Emmanuel-Joseph Sieyès, (1748-1836), *Qu'est-ce que le Tiers état?* ([Reprod.]) [par Sieyès], 1789.

Pikëpamja sipas së cilës trupi zgjedhor paraqet një strukturë të përbërë dhe të diferencuar që nuk mund të shprehet në parlamentin njëdhomësh qëndron në themel të arsyetimit të ekzistencës së trupave përfaqësuese me dy ose më shumë dhoma. Në **dhomën e ulët**, përfaqësuesit e qytetarëve më së shpeshti zgjidhen, më rrallë caktohen (nominohen), kurse në **dhomën e sipërme** ulen përfaqësuesit e territoreve të caktuara, kombeve, profesioneve, personave me status të posaçëm dhe kështu me radhë. Kjo dhomë, dhoma e sipërme, shërben edhe si një trup për ndarjen e thellë të pushtetit, sepse ndarja në fjalë përshkon thellësinë e pushtetit ligjvënës, që mund të jetë garancion për ligje dhe vendime të kujdesshme dhe cilësore. Kjo dhomë shërben edhe si një formë shtesë e kontrollit të dhomës së ulët.

Parlamenti është populli në miniaturë, simbol i sovranitetit popullor dhe i vetë shtetit. Meqë është trup përfaqësues i të gjithë qytetarëve, disa pyetje shtrohen lidhur me përbërjen e tij. Në rend të parë shtrohet pyetja nëse parlamenti duhet të ketë vetëm përfaqësuesit e qytetarëve (shtetasve) që jetojnë në shtet apo edhe i atyre që jetojnë në botën e jashtme, siç e kanë disa parlamente në Evropë e më gjerë (Franca, Italia, Kroacia etj.)? Përgjigja në këtë pyetje lidhet me pagimin e tatimit – ata që nuk paguajnë tatim në shtet nuk duhet të kenë përfaqësim në parlamentin që vendos për tatimet. Ky standard është konform rregullit të vjetër që lindi në **Revolucionin Amerikan** (1765-1791), që thotë se nuk ka përfaqësim pa tatim ("no representation without taxation"): Parlamenti britanik kishte të drejtë të vinte tatime e taksa për kolonitë amerikane, të cilat nuk ishin të përfaqësuara në të.

Parlamenti është përfaqësi e partive politike, pa të cilat puna e tij do të ishte e pamundur, sepse ato drejtojnë dhe disiplinojnë përfaqësuesit. Në këtë kuptim, partitë politike mund të kenë interesa të veçanta që përfaqësojnë në parlament, nganjëherë të ndryshme dhe të kundërta me interesat e zgjedhësve që i kanë votuar për to. Në parlamentet bashkëkohore në disa vende, në veçanti insistohet në përfaqësimin e komuniteteve dhe grupeve pakicë dhe të cenueshme. Ekzistojnë kuotat zgjedhore me të cilat sigurohet përfaqësimi i gjinive, lehtësohet dhe mundësohet përfaqësimi i përfaqësueseve të pakicave kombëtare dhe pakicave të tjera - përmes vendeve të rezervuara ose me eliminim të pengesave zgjedhore. Në përpjekje e veçantë gjithashtu ekziston në konstitucionalizmin bashkëkohor që të përfaqësohen të gjitha pjesët gjeografike të territorit shtetëror, nga të gjitha anët e shtetit, konform kërkesës për përfaqësim territorial, që praktikisht realizohet me krijimin e njësive të vogla zgjedhore, përmes përfaqësuesve të njësive federale, regjioneve ose njësive të vetëqeverisjes lokale në dhomën e sipërme dhe në mënyra të tjera adekuate.

Zgjedhja drejtpërdrejtë e përfaqësuesve qëndron në themel të legjitimitetit më të madh të parlamentit kundrejt organeve të tjera (qeverisë, shefit të shtetit që zgjidhet në zgjedhje të tërthorta). Zgjedhja e përfaqësuesve, megjithatë, mund të reflektoj nivele të ndryshme të drejtpërdrejtshmërisë në raport me zgjedhësit. Prandaj edhe përfaqësuesit mund të kenë nivele të ndryshme të legjitimitetit. Lidhja më e drejtpërdrejtë mes zgjedhësit dhe përfaqësuesit ekziston në njësitë e vogla zgjedhore (njënominale) dhe këtu deputetët e zgjedhur kanë legjitimitetin më të madh. Në sistemin zgjedhor proporcional, legjitimiteti i takon partisë në listën e së cilës kanë qenë deputetët e zgjedhur, më shumë se vetë anëtarëve të parlamentit. Megjithatë, marrë si tërësi, parlamenti zakonisht është më pak legjitim kur zgjidhet sipas sistemit zgjedhor mazhoritar, nga shkaku se më pak e shpreh zgjidhjen politike të zgjedhësit krahasuar me parlamentin që zgjidhet sipas sistemit zgjedhor proporcional.

Faktorë të ndryshëm ndikojnë në numrin e përfaqësuesve, përkatësisht në madhësinë e parlamentit. Në këtë kuptim, parlamenti duhet të plotësojë së paku **dy kushte**. E para, ky trup duhet të jetë përfaqësues i krejt popullit/kombit – nga të gjitha pjesët e shtetit dhe grupet e ndryshme shoqërore. Ky kusht i përfaqësimit nuk mund të realizohet nëse parlamenti është i vogël në numër. Kushti i dytë që ndikon në madhësinë e parlamentit ka të bëjë me kërkesën për efektivitet dhe efiçencë të punës së tij. Parlamenti i stërmadh është i ngadalshëm në punë nga shkaku se përbërja e tij është, sipas rregullit, politikisht shumë e ndryshme, gjë që nënkupton se me rastin e vendimmarrjes ndeshen qëndrimet e nduarndurshme. Kriteri i efikastitetit dhe efiçencës nuk guxon të jetë arsye e vetme e zvogëlimit të numrit të përfaqësuesve, në veçanti të shkojë deri në atë shkallë sa të eliminojë debatin (shqyrtimin) parlamentar, në të cilin propozimet mbështeten dhe

kontestohen në mënyrë të argumentuar. Zvogëlimi i numrit të mbrohet edhe me argumentet e ekonomitetit – zvogëlimin e shpenzimeve të parlamentit për shkak të numrit të vogël të rrogave të përfaqësuesve dhe mëditjeve të tyre.

Numri i përfaqësuesve varet nga numri i popullsisë. Kështu, ta zëmë, vendet me popullsi të madhe, sipas rregullit, kanë parlamente me më shumë përfaqësues (Kina deri në 2.987; vendet e mëdha evropiane: Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Italia etj). Një faktor tjetër që ndikon në numrin e përfaqësuesve është tradita: **Franca**, ta zëmë, ka 577 përfaqësues që nga koha e revolucionit që e bëri **shtresa e tretë**. Pastaj vijnë faktorë të tjerë, si: rregullimi shtetëror, struktura e vetë parlamentit (një ose më shumë dhoma, trupat permanentë të tij dhe kështu me radhë), efikasiteti i punës dhe shpenzimet e punës. Numri i përfaqësuesve paraprakisht dihet atëherë kur **ai numër përcaktohet me kushtetutë në shifra absolute** (ta zëmë: Franca, Italia, Kosova, Rusia, SHBA etj.), **me ligj** (ta zëmë: Gjermania), **kur kushtetuta përcakton numrin më të madh dhe numrin më të vogël që duhet ta ketë parlamenti**, kurse numrin e saktë në shifra absolute e përcakton **ligji** (ta zëmë, Kroacia, Portugalia, Spanja etj.), **kur numri i caktuar i zgjedhësve ose qytetarëve zgjedh një deputet** ashtu që mund të përcaktohet edhe para zgjedhjeve (ta zëmë, Britania e Madhe). Numri përfaqësuesve mund të dihet vetëm pas zgjedhjeve atëherë kur zbatohet kriteri sipas të cilit një deputet zgjidhet nga një numër i paracaktuar i zgjedhësve që dalin në zgjedhje (ta zëmë: njësia federale Baden në **Gjermaninë e Vajmarit**, 1918-1933).

2.3. Mandati i deputetëve

Për të fituar mandatin e përfaqësuesit kërkohet plotësimi i dy kushteve themelore: që kandidati të ketë të drejtën pasive zgjedhore dhe të fitoj numrin e caktuar të votave. Të drejtën pasive zgjedhore e përbëjnë elementet siç janë: shtetësia, mosha madhore, zotësia për të vepruar, vendbanimi dhe mospërputhshmëria e funksioneve si kusht negativ. Funksionet që nuk janë në përputhje me mandatin e përfaqësuesit dhe në përgjithësi me veprimtarinë politike mund të jenë: funksioni gjyqësor ose i prokurorisë publike, ushtria dhe policia, funksionet në organet tjera të pushtetit të nivelit horizontal dhe vertikal. Mandati i përfaqësuesit fitohet në zgjedhje të drejtpërdrejta. Në sistemin mazhoritar, kandidati si individ, së bashku me kandidatët tjerë, merr pjesë në zgjedhje. Ai fiton mandatin me emrin e vet, nëse është anëtar i partisë politike, atëherë edhe falë aktiviteteve të veta partiake. Në zgjedhjet sipas sistemit proporcional, ndërkaq, kandidati gjendet në listën zgjedhore së bashku me kandidatët tjerë nga partia politike, koalicioni zgjedhor apo në listën e shoqatës së qytetare. Në këtë rast, përfaqësuesi fiton mandatin pikërisht për shkak se votuesit kanë votuar për partinë politike.

Kohëzgjatja e mandatit të përfaqësuesit, **legjislatura**, është e ndryshme dhe në të shumtën e rasteve përcaktohet më kushtetutë. Zgjat nga dy vite (Dhoma e Përfaqësuesve e SHBA-së) deri në dhjetë vite (Senati i SHBA-së), kurse zakonisht ai është katër ose pesë vite. Mandati i përfaqësuesve duhet të jetë mjaftueshëm i gjatë, të mundësoj që përfaqësuesi të ketë kohë të nevojshme për përkushtim ndaj kompetencave te veta dhe arritje të rezultateve. Mandati i përfaqësuesit në të njëjtën kohë duhet të jetë i kufizuar, në mënyrë që periodikisht, në zgjedhje, të verifikohet legjitimiteti përfaqësues. Mandati zakonisht nis me **dhënien e betimit**, kurse para dhënies së tij, pas **shpalljes përfundimtare të rezultateve** (certifikimi), vërtetohen mandatet e përfaqësuesve dhe konstitutohet parlamenti.

Në rrethana të caktuara, mandati i përfaqësuesve mund të jetë më i shkurtër ose më i gjatë se ai i përcaktuar me kushtetutë e ligj. Në rast të shpalljes së gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme për çfarëdo arsye qoftë, atëherë përfaqësuesve u vazhdohet mandati, nëse ka skaduar, atëherë ai vazhdohet deri në mbarim të gjendjes së luftës apo gjendjes së jashtëzakonshme. Është interes ekzistencial i shtetit që organi përfaqësues të veprojë edhe në situata të tilla. Shkaku i këtij interesi, kushtetutat përcaktojnë që në situata të tilla ky organ nuk mund të shpërndahet. Në anën tjetër, nëse vjen deri te shpërndarja konform kushtetutës dhe ligjit, atëherë të gjithë përfaqësuesve iu shkurtohet mandati. Ekzekutivi shpërndan organin përfaqësues para mbarimit të mandatit, zakonisht për të krijuar një për-

bërje të re të ndryshme të përfaqësimit. Përfaqësuesit individual, ndërkaq, mandati i ndërpritet nëse jep dorëheqje, vdes, humb të drejtën pasive të votës, ushtron funksion tjetër të papajtueshëm më funksionin e përfaqësuesit. Ekzistojnë edhe disa arsye të tjera, por më të rralla, të ndërprerjes së parakohshme të mandatit, siç janë ta zëmë: shkelja e rregullave të punës me mosprani të gjatë dhe pa arsye në seancat e parlamentit (Austria) ose për shkak të pushimit të anëtarësimit në partinë politike (dikur në Serbi, tani në Indi dhe disa vende të tjera, ku nuk lejohet kalimi apo ndërrimi partisë).

Sipas natyrës, mandati përfaqësues mund të jetë **i detyrueshëm** (i lidhur) ose **jo i detyrueshëm** (i lirë). I pari, **mandati i detyrueshëm**, sot pothuajse është i tejkaluar dhe ka pasur të bëj me marrëdhënien me përfaqësuesit dhe votuesit e tyre, të cilët kanë pasur të drejtën e dhënies së urdhrave dhe revokimit të tyre nëse nuk zbatonin urdhrat e dhënë. Ky lloj mandati që nga koha **Revolucionit Francez** është marrë si inekzistent, sepse është konsideruar se urdhrat e dhënë nuk mund të prodhojnë efekte juridike, janë të pavlefshëm. Mandati i detyrueshëm sot ekziston në **dy situata**. Rasti parë ka të bëj me situatën e anëtarëve të **dhomës së lartë** nëpër **federata**, të cilët përfaqësojnë njësitë federale dhe votojnë si një delegacion ("en block"), bazuar në instruksionet dhe urdhrat e njësisë federale (ta zëmë, Bundesrati gjerman). Kur janë të zgjedhur në mënyrë të tërthortë, përkatësisht kur janë të deleguar, atëherë ata mund të revokohen për shkak të mosrespektimit të instruksioneve dhe urdhrave të marra. Rasti dytë i mandatit të detyrueshëm ka të bëj me marrëdhënien e përfaqësuesit me partinë e vet politike: nëse lëshon partinë ose përjashtohet nga ajo, atëherë humb mandatin dhe zëvendësohet më një kandidat tjetër partiak nga lista zgjedhore e sistemit proporcional. Kjo natyrë e mandatit të përfaqësuesve ekziston te një numër shumë i vogël i shteteve (ta zëmë, Afrika e Jugut, Bangladeshi, Panama). Aktualisht dominon zgjidhja kushtetuese e mandatit të lirë, sipas të cilit ndërprerja e anëtarësimit në partinë politike nuk ka efekt dhe ndikim në mandatin e përfaqësuesit.

Mandati i lirë është ai që përfaqësuesit i mundëson të veproj dhe vendos sipas bindjes së vet, jo sipas instruksioneve dhe urdhrave të votuesit, partisë politike ose njësisë federale. Kjo nënkupton se përfaqësuesi përfaqëson dhe paraqet interesat e krejt qytetarëve, krejt popullit/kombit, jo vetëm të atyre që kanë votuar për të. Mandati lirë nënkupton që përfaqësuesi ruan mandatin edhe nëse ikë nga partia politike anëtar i së cilës ka qenë në zgjedhje, nëse bëhet përfaqësues i pavarur apo kalon në një parti apo grupim tjetër.

Me qëllim të ruajtjes të natyrës së mandatit të lirë dhe ndarjes së pushtetit, përfaqësuesit gëzojnë imunitet. **Imuniteti material** mbron përfaqësuesin nga përgjegjësia për mendimin e shprehur në debatet e parlamentit, për fjalim dhe votim. Ky njihet ndryshe edhe si **imuniteti (lirimi) nga përgjegjësia** ("non-liability immunity"). Për nga natyra është absolut, sepse nuk mund të merret, dhe i përjetshëm, sepse vazhdon edhe pas mbarimit të mandatit. Imuniteti në fjalë ka rrënjët e veta në Britaninë e Madhe, nga koha e **Ligjit për të drejtat** i vitit 1689 ("Bill of Rights"), me të cilin mbrohej e liria e fjalës në parlament, e cila nuk mund të kontestohej apo anulohej në gjykatë apo jashtë parlamentit. Për këtë lloj imuniteti përdoret edhe shprehja **imunitet funksional**, sepse lidhet tërësisht për ushtrimin e funksionit të përfaqësuesit.

Imuniteti procedural e përjashton përfaqësuesin nga ndjekja, gjykimi dhe burgosja penale. Ky është **imuniteti i paprekshmërisë** ("inviolability immunity") dhe nuk ekziston në të gjitha shtetet (ta zëmë në Britaninë e Madhe). **Imuniteti procedural** nuk është absolut sepse mund të merret nëse parlamenti vendos për një gjë të tillë. Ky imunitet nuk është i përhershëm, me ndonjë përjashtim (ta zëmë në **Republikën Çeke**), sepse mbron përfaqësuesin vetëm gjatë kohës së ushtrimit të mandatit. Me kushtetutë përcaktohen përjashtimet kur përfaqësuesi mund të ndalohet, paraburgoset, ndiqet penalisht, përkundër që gëzon imunitet procedural. Është interes i përgjithshëm që, nëse deputeti kryen ndonjë vepër penale serioze, zihet në flagrancë, siç janë, ta zëmë, tradhtia, vrasja etj., kundër tij të niset procedura penale. Kjo nënkupton që imuniteti mund të

hiqet dhe të fillojë ndjekja penale vetëm pas analizimit të substancës së akuzave të ngritura nga organi i ndjekjes. Në këtë kuptim, ky mund quhet ndryshe edhe si **imunitet jofunksional**, për faktin se nuk ka të bëj me veprimet që lidhen me ushtrimin e funksionit të përfaqësuesit. Analizën e akuzave dhe aspekteve të tjera që shërbejnë si bazë për kërkesën për heqjen e këtij imuniteti e bën autoriteti kompetent shtetëror, përkatësisht dhënësi i imunitetit, që në rastin konkret është parlamenti nacional.[55]

Dy imunitetet si më sipër, **imuniteti material** (lirimi nga përgjegjësia) dhe **imuniteti procedural** (imuniteti paprekshmërisë), nuk mbrojnë përfaqësuesit nga përgjegjësia disiplinore. Nëse përfaqësuesi shkel rregullat mbi punën e parlamentit që kanë të bëjnë me respektimin e procedurës dhe të vetë punës në të, ndalimin e ofendimeve dhe shpifjeve dhe sjelljeve të tjera jodinjitoze dhe moszbatim të detyrimeve, atëherë mban përgjegjësi disiplinore. Kryetari i parlamentit apo kryesuesi i seancës, mund të shqiptojë sanksione disiplinore ndaj shkelësit të tillë të rregullave mbi punën e brendshme të parlamentit, siç janë: vërejtja, dënimi me të holla, largimi i përkohshëm dhe i përhershëm nga seancat dhe, në raste të jashtëzakonshme, edhe marrja e mandatit të përfaqësuesit (ta zëmë, në **Maqedoninë e Veriut**, mandati mund t'i merret përfaqësuesve që bojkotojnë punën e parlamentit).

2.4. Kompetenca

Me ndarjen e punëve shtetërore, që buron nga parimi ndarjes së pushtetit, parlamentit i ka takuar pushtetit ligjvënës. Miratimi ligjeve përbën **kompetencën normative** të parlamentit. Përveç kompetencën normative, parlamenti ka edhe kompetencën kontrolluese, e cila kryesisht është e drejtuar kundër qeverisë (ekzekutivit). Një grup të posaçëm të punëve të parlamentit e formojnë **kompetencat në sferën zgjedhore dhe të personelit**. Krahas këtyre tri grupeve të kompetencave, parlamenti kryen edhe punë të tjera të ndryshme që mund të përmblidhen në një grup të ndarë.

Kompetenca normative e parlamentit është puna e tij kryesore dhe më e rëndësishme. Ajo përfshinë funksionin ligjvënës - nxjerrjen e ligjeve, funksionin kushtetutëbërës – nxjerrjen e kushtetutës si aktin më të lartë juridik. Në procedurën ligjvënëse dhe kushtetutëbërëse, megjithatë, parlamenti nuk vepron i vetëm. Procedura ligjvënëse që zhvillohet në parlament, në të vërtetë është një fazë e ndërmjetme, në ndërkohë që fillimi dhe fundi i saj është në duart e ekzekutivit. Është qeveria ajo që zakonisht propozon shumicën e ligjeve dhe nis procedurën e ligjvënies, sipas rregullit, kurse shefi i shtetit në fund të procedurës shpallë ligjin paraprakisht të votuar. Parlamenti, miraton ligje në një procedurë, që jo domosdo është e njëtrajtshme. Në këtë kuptim mund të dallohen procedura për miratimin e ligjeve të zakonshme, organike, kushtetuese, ligjeve për ratifikim të marrëveshjeve ndërkombëtare, ligjeve për amnistinë, buxhetin, si dhe të ligjeve që janë vërtetuar në referendum, për miratimin e të cilave kërkohen shumica të ndryshme të votave parlamentare.

Miratimi i ligjeve është i ndryshëm në parlamentet njëdhomëshe nga miratimi në parlamentet dydhomëshe. Në parlamentin që ka një dhomë, shqyrtimi dhe votimi për propozimin e ligjit kryhet nëpër komisione e trupa të parlamentit dhe në seancë plenare ku debatojnë dhe shqyrtojnë të gjithë përfaqësuesit. Kur dhoma e lartë ka autorizime të njëjta të ligjvënies sikur dhoma e ulët (ta zëmë: SHBA, Italia etj.), atëherë në dy dhomat duhet të votohet ligji në tekstin e njëjtë. Kur kjo nuk ndodhë, vjen deri të "kolizioni dhomave", që paraqet një fazë të veçantë në të cilën, përmes bisedimeve në komisione të përbashkëta, bëhet përpjekje për harmonizim të tekstit të përbashkët të ligjit të ardhshëm.

[55] Cf. më shumë për këtë në kontekstin e gjyqësorit të rregullt dhe gjyqësisë kushtetuese, në Enver Hasani & Muhamet Brahimi, *Gjyqësia kushtetuese*, fq. 531-564.

Aktiviteti ligjvënës i parlamentit është specifik në **federata**, sepse edhe parlamentet e njësive federale kanë pushtet ligjvënës. Kur bëhet fjalë për materien në kompetencë të përbashkët, parlamenti i federatës miraton ligjin kuadër, kurse njësia federale me ligjin e vet përpunon tutje bazat ligjore të federatës. Në procedurën e miratimit të ligjeve, formalisht mund të marrin pjesë edhe qytetarët, nëse paraqesin propozimin e ligjit në parlament (iniciativa popullore) apo nëse e vërtetojnë në referendum. Edhe pjesëmarrja e qytetarëve në shqyrtimin publik të propozimligjit, në njëfarë mënyre paraqet pjesëmarrje të qytetarëve në procedurën e ligjvënies.

Funksioni **kushtetutëbër**ës i parlamentit nuk është veprimtari e tij primare, për shkak se kushtetuta miratohet dhe ndryshohet shumë më rrallë se ligjet. Në procedurën e kushtetutëbërjes, parlamenti gjithashtu nuk vepron i vetëm por me subjekte të tjera: me votuesit, përbërjen e re të parlamentit, parlamentet e njësive federale, si dhe me kombinime të ndryshme të veprimtarisë së këtyre subjekteve.
Funksioni normativ i parlamentit nuk konsiston vetëm në ligjvënie dhe kushtetutëbërje, por edhe në nxjerrjen e akteve të tjera. Fjala është për **rezoluta** dhe **deklarata**, të cilat janë, për nga natyra e tyre, akte politike, pastaj për akte nënligjore si: vendime, rregulla, plane dhe strategji. Një akt i veçantë normativ i parlamentit, që është një burim i rëndësishëm i të drejtës kushtetuese, paraqet **rregullorja e tij punës**. Me këtë akt përcaktohet organizimi i brendshëm i parlamentit – zgjedhja dhe autorizimet e drejtuesve të tij, këshillat dhe trupat tjerë, grupet parlamentare, si dhe procedura e vendimmarrjes. Në parlamentin dydhomësh, dy dhomat miratojnë rregulloret e tyre të punës.

Veprimtaria normative e parlamentit, veçanërisht miratimi i ligjeve, ka tendencë të zvogëlimit dhe bartjes sa më shumë në pushtetin ekzekutiv, përkatësisht në qeverinë parlamentare. Përmes ligjvënies së deleguar, qeveria fiton autorizim për nxjerrje të ligjeve në një periudhë të caktuar dhe në fusha të dhëna, që më pastaj, pas nxjerrjes së tyre, ato i dërgohen parlamentit vetëm për konfirmim (ta zëmë: Franca, Italia, Kroacia). Ekzistojnë edhe zgjidhje kushtetuese ku qeveria **është** praktikisht miratues i ligjit, kurse parlamenti ka në duar pushtetin legjislativ vetëm në fushat saktësisht dhe në mënyrë shprehimore të numëruara në kushtetutë (ta zëmë, Franca).

Kompetenca kontrolluese e parlamentit ka të bëj, në rend të parë, me marrëdhënien me qeverinë. Marrë në përgjithësi, parlamenti është organ pasiv kundrejt qeverisë. Parlamenti pret, kurse qeveria propozon ligje dhe akte të tjera dhe në këtë mënyrë vë në lëvizje dhe kontrollon punën e tij. Me miratimin e propozimeve të qeverisë, parlamenti në të vërtetë kontrollon aktivitetet e qeverisë që i kanë paraprirë propozimit ligjor, sikundër edhe vetë propozimin në fjalë. Në aspektin juridik-kushtetues, **kontrolli parlamentar** është i konceptuar si kontroll gjithëpërfshirës, ku objekt kontrolli **është** puna e tërësishme e pushtetit qeverisës, por edhe si kontroll i pjesshëm, ku objekt kontrolli është politika e ekzekutivit në lëmi të caktuara apo propozimi i ndonjë akti konkret. Kompetenca kontrolluese e parlamentit përfshinë kontrollin politik dhe kontrollin juridik të qeverisë. Ky i fundit mund të çoj në mosmiratimin e një akti juridik që ka propozuar qeveria. Kontrolli politik, ndërkaq, mund të ketë për rrjedhojë votimin e mosbesimit të qeverisë.

Funksioni kontrollues i parlamentit ka efekt të kufizuar. Caqet e saj shtrihen në ndikimin relativ në punën e qeverisë, që mund të çoj deri te korrigjimi i një propozim-ligji, por nuk mund ta detyroj qeverinë të heq dorë nga propozimi tillë. Fare thjeshtë, parlamenti nuk ka aq vota sa për të refuzuar propozimin e qeverisë, sepse pas tij qëndron shumica parlamentare. Pikërisht për këtë arsye edhe kontrolli konsiston në aktivitetin e opozitës në parlament, e cila i drejtohet opinionit publik me qëllim përfitimin e tij si aleat të fuqishëm në punët e kontrollit të ekzekutivit. Vetëm atëherë kur opinioni publik ngrihet fuqishëm kundër ndonjë akti të ekzekutivit, mund të vije deri te rritja e gjasave për sjellje oportune të pushtetit ekzekutiv - ndryshimi i propozimit ose heqja dorë në tërësi nga ai. Kjo nënkupton se, në përgjithësi, gjatë ushtrimit të funksionit kontrollues të parlamentit, përfaqësuesit e opozitës animojnë publikun dhe përgatiten për zgjedhjet e ardhshme, të vetëdijshëm se në pakicë nuk kanë një mjet juridik për të detyruar dëgjueshmërinë e qeverisë.

Instrumente të kontrollit parlamentar janë: **pyetjet parlamentare**, **interpelanca**, **votimi për mosbesimin e qeverisë**, **anketat** dhe **hetimet** parlamentare. Një instrument i posaçëm i kontrollit është **e drejta buxhetore e parlamentit**, kurse si instrument specifik është edhe votimi për **votëbesimin** e qeverisë.

Pyetje parlamentare mund të parashtroj secili përfaqësues, për kryeministrin, krejt qeverinë ose ndonjërin prej anëtarëve të qeverisë, sipas mënyrës së përcaktuar me rregulloren e punës. Me pyetje opozita mund të zhysë qeverinë ose anëtarët e saj, përfshirë kryeministrin, në gjendje të pakëndshme, mirëpo kjo nuk çon në votim të mocionit të mosbesimit të ekzekutivit ose ndonjërit prej anëtarëve të tij. Atij të cilit i drejtohet pyetja, përgjigjet menjëherë. Për përgjigje nuk zhvillohet debat ose shqyrtim, mirëpo vetë përfaqësuesi ka të drejtë të komentoj përgjigjen. Përmes pyetjeve të përfaqësuesve, opozita në të vërtetë informon publikun mbi aktivitetet e qeverisë që asaj nuk i shkojnë në favor, mbi aferat, mossukseset, gabimet.

Interepelacioni (nga fjala latine "interprellation", që do të thotë ndërprerje e fjalimit të dikujt me pyetje) është një pyetje lidhur me punën e qeverisë që i parashtrohet shefit të qeverisë ose anëtarit të qeverisë, por pas së cilës qëndrojnë disa përfaqësues. Kjo ndryshe quhet edhe **pyetje e kualifikuar parlamentare**, si për shkak të numrit të atyre që e bëjnë, ashtu edhe shkaku i pasojave që prodhon. Lidhur me interpelancën hapet debat parlamentar, i cili, në fund, mund të çoj në votim të mosbesimit të qeverisë. Kjo ndodhë nëse parlamenti, pas përfundimit të debatit, nuk pranon përgjigjen e dhënë në interpelancë. Nganjëherë kjo është një protestë më e rrezikshme e opozitës kundër qeverisë dhe paralajmërim që qeveria mund të humb mbështetjen e parlamentit dhe bije nga pushteti. Në disa vende interpelancat kanë qenë mjet i fuqishëm parlamentar i kontrollit të punës dhe rrëzimin e qeverisë (ta zëmë, Republika e tretë dhe e katër franceze, përgjatë viteve 1875-1958).

Votimi mosbesimit të qeverisë është instrument i kontrollit parlamentar që ka për qëllim rrëzimin e qeverisë, e vetëm më pastaj kontrollin e punës së saj. Kjo procedurë nis në rrethana të ndryshme politike. Nëse opozita është e sigurt që nuk i ka votat e duhura për rrëzimin e qeverisë, debati që iniciohet shërben si një informim për publikun rreth qëndrimeve të opozitës lidhur me qeverinë. Nëse opozita ka fituar shumicën e nevojshme në parlament apo nëse konstatohet se kjo shumicë mund të arrihet në parlament gjatë debatit, atëherë qëllim i vetëm i kësaj procedure është votimi i mosbesimit të qeverisë. Në disa vende ekziston instrumenti i **votimit konstruktiv të mosbesimit të qeverisë** (Gjermania, Hungaria, Spanja). Me këtë instrument, pozita e qeverisë bëhet më stabile sepse votimi mocionit të mosbesimit është i vështirësuar dukshëm: nuk mund të rrëzohet qeveria nëse nuk ofrohen prova (deklaratat e përfaqësuesve të partive parlamentare) mbi formimin e shumicës parlamentare që do të mbështet qeverinë e re që do të krijohet pas rrëzimit të qeverisë së vjetër.

Një instrument i veçantë i kontrollit parlamentar është **e drejta buxhetore e parlamentit**. Me propozimin e qeverisë, parlamenti miraton ligjin për buxhetin me të cilin miratohen mjetet financiare për punën e qeverisë dhe administratës shtetërore si në vitin në vijim. Kjo nënkupton se pa miratimin e ligjit për buxhetin, qeveria detyrohet të largohet nga pushteti sepse nuk posedon mjete materiale në bazë të të cilave do të zbatonte politikën e vet. Në të njëjtën kohë, mosvotimi buxhetit është dëshmi se qeveria ka humbur shumicën parlamentare. E drejta buxhetore, megjithatë, nuk e ka më rëndësinë e instrumentit të kontrollit që në mënyrë automatike sjell rrëzimin e qeverisë. Kjo për shkak se, në rast të mosmiratimit të buxhetit, zakonisht vazhdohet vlefshmëria e buxhetit të vjetër edhe për periudhën në vijim, përveç kur dështimi i miratimit të buxhetit shoqërohet me dorëheqje të qeverisë apo votim të mosbesimit.

Anketat parlamentare dhe **hetimet** (e ngjarjeve të caktuara, punëve dhe aktiviteteve), përmes trupave anketues **ad hoc** të posaçëm, janë instrument i veçantë i kontrollit parlamentar. Trupat në fjalë, që kanë formën e këshillave ose komisioneve parlamentare **ad hoc**, formohen me kërkesë

të opozitës, nëse ekziston një kërkesë e fuqishme për kryerjen e hetimeve parlamentare lidhur me aktivitetet e qeverisë ose të anëtarëve të saj. Ky themelim bëhet si rezultat i kërkesës së fuqishme të opozitës që mbështetet nga opinioni publik. Në vendet ish-komuniste dhe në vendet në tranzicion, kanë qenë mjaft të shpeshta hetimet lidhur me transformimin e pronës shoqërore/shtetërore në pronë private. Mjaft rrallë, edhe vetë qeveria propozon hetimin parlamentar të ndonjë rasti. Trupi anketues, këshilli ose komisioni, pas mbarimit të hetimit përpilon raport që ia paraqet parlamentit dhe për të cilin mund të zhvillohet debat.

Një mjet krejtësisht specifik i kontrollit parlamentar është **votimi i besimit të qeverisë**. Specifika e tij konsiston në atë se vetë qeveria është inicuese mocionit të votëbesimit, gjë që bën të dallueshëm nga **votimi mosbesimit të qeverisë**, i diskutuar më sipër. Për këtë arsye, del pak problematike cilësimi i tij si instrument në duart e parlamentit. Marrë parasysh se për kërkesën e qeverisë për votëbesim zhvillohet debat, siç janë situatat kur qeveria e lidh votëbesimin ndaj saj me miratimin e ndonjë ligji (ta zëmë, ligjit për ngritjen e tatimeve apo uljen e të hyrave shoqërore), atëherë mund të thuhet se **votëbesimi** paraqet një mundësi të mirë për opozitën për të kritikuar dhe kontrolluar punën e qeverisë. Në fund të debatit votohet: nëse votohet besimi ndaj qeverisë, atëherë automatikisht miratohet edhe ligji që qeveria e ka lidhur me votimin e mosbesimit (Franca). Qeveria mund të kërkoj që të votohet besimi ndaj saj si pjesë e përkrahjes ndaj politikës së përgjithshme që udhëheq, duke forcuar kësisoj legjitimitetin e vet. Në të kundërtën, nëse nuk fiton besimin, qeveria bie nga pushteti.

Kompetenca në sferën zgjedhore dhe të personelit ka të bëj me zgjedhjet brenda parlamentit dhe zgjedhjes së funksionarëve dhe zyrtarëve të tjerë. Parlamenti ka të drejtë të zgjedh udhëheqjen e vet, zyrtarët e tij: kryetarin apo kryeparlamentarin, nënkryetarët dhe sekretarin. Parlamenti zgjedh anëtarët e këshillave dhe konstaton plotësimin e kushteve për formimin e grupeve apo klubeve parlamentare. Përveç brenda parlamentit, kompetenca në sferën zgjedhore dhe të personelit shtrihet edhe ndaj degëve të tjera të pushtetit. Në themel të parlamentarizmit qëndron zgjedhja e qeverisë nga parlamenti dhe, krahas kësaj, parlamenti në disa vende zgjedh edhe shefin e shtetit, organet e drejtësisë, gjyqtarët kushtetues, avokatin e popullit, guvernatorin, prokurorët etj.

Kompetenca e personelit zbatohet në atë mënyrë që, zakonisht të tjerët parashtrojnë propozimin e bartësit të funksionit kurse parlamenti debaton dhe voton për propozimin. Shumë rrallë krejt procedura e propozimit dhe zgjedhjes kryhet në parlament. E drejta e parlamentit për shkarkim të shefit të shtetit është e drejtë e posaçme zgjedhore dhe logjikisht buron nga e drejta e tij për të zgjedhur këtë organ të rëndësishëm të shtetit. Kjo e drejtë, megjithatë, ekziston edhe në vendet ku shefi shtetit zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët. Kjo e drejt heq origjinën e vet nga e drejta mesjetare e **impeachment**-it në vendet anglo-saksone (shekulli XIV), sipas së cilës parlamenti ka të drejtë të gjykoj njëjtë si gjykatat e rregullta, funksionarët e lartë dhe të shqiptojë dënimin e shkarkimit të tyre në rast të korrupsionit, veprave penale dhe sjelljeve të këqija. Kjo ka nisur për herë të parë në **Angli** në vitin 1376 në kohën e **Eduardit** III të Anglisë (Edward III: 1312-1377) dhe parlamentit të njohur me emrin "Parlamenti i mirë" (1376). Më pas ka figuruar në **Kushtetutën e SHBA-së** (1787) pas pavarësimit dhe, më pas, edhe në **Kushtetutën e Vajmarit** (1919).[56]

Nga kompetencat tjera të parlamentit mund të veçohen e drejta e **shpalljes së referendumit**. Parlamenti shpall referendum kur dëshiron të ndaj përgjegjësinë me qytetarët lidhur me nxjerrjen e ndonjë ligji, marrjen e një vendimi politik (ta zëmë, anëtarësimi në një aleancë ushtarake apo nxjerrjen e ndonjë rezolute) apo amendamentimin e kushtetutës, kur ekziston një mundësi e tillë. Këtu bëhet fjalë për referendum nacional, në të cilin deklarohen të gjithë qytetarët. Në këtë grup

[56] Cf. më shumë në T. F. T. Plucknett, "The Origin of Impeachment" *Transactions of the Royal Historical Society* Vol. 24 (1942), fq. 47-71.

të kompetencave të parlamentit mund të futet edhe vendimi për amnistinë. Legjislacioni mbi amnistinë me të cilën qytetarët falen nga ndjekja penale, lirohen nga ekzekutimi i dënimit, dënimi u zvogëlohet, ata rehabilitohen etj., është një legjislacion i posaçëm sepse ka fuqi retroaktive. Me këtë legjislacion parlamenti, në disa rrethana të posaçme, zakonisht pas ndryshimit të pushtetit, shpërfaq mirësinë dhe butësinë e shtetit.

Parlamenti ka kompetenca edhe në **sferën e mbrojtjes dhe sigurisë së shtetit**, si në rrethanat normale ashtu edhe gjatë kohës së krizave. Në jetën e zakonshme të shtetit, parlamenti miraton ligjet dhe strategji lidhur me mbrojtjen dhe sigurinë e vendit, kontrollon punën e shërbimeve ushtarake dhe policore. Në kushte të luftës dhe gjendjeve të jashtëzakonshme, parlamenti mblidhet pa ndonjë ftesë të posaçme dhe nxjerr vendime të domosdoshme për funksionimin e shtetit në kushtet dhe gjendjet e tilla.

2.5. Organizimi i brendshëm

Parlamenti ka një strukturë të ndërlikuar, në të cilën dallohen vendet nga ku **punohet**, **udhëhiqet** dhe **vendoset**. Ndarja themelore e punës në parlament është në aktivitete që kryhen në **komisione (**trupa) parlamentare dhe në **seanca plenare** të të gjithë deputetëve. Përveç këtyre, aktivitetet zhvillohen edhe në **grupet parlamentare** dhe në formate të veçanta siç është kolegjiumi në të cilin bëjnë pjesë liderët e grupeve parlamentare dhe zyrtarët e lartë të parlamentit. Çështjet e organizimit të brendshëm të parlamentit, në mënyrë të detajuar normohen me rregulloren e punës.

Në krye të parlamentit gjendet kryetari, ndërkombëtarisht i njohur si **speaker**, që përfaqëson këtë organ dhe udhëheq me të. Funksioni i kryetarit të parlamentit është një funksion individual (vetjak). Nëse parlamenti është dydhomësh, secila dhomë ka kryetarin e vet. Në disa vende, krahas kryetarit, me parlamentin udhëheq kolegjiumi (ta zëmë, Franca, Gjermania). Kryetarin e parlamentit e zgjedh shumica parlamentare, zakonisht nga radhët e saj, për krejt mandatin zgjedhor. Nga ky rregull ekzistojnë përjashtime: në disa vende kryetari i dhomës parlamentare mund të caktohet sipas funksionit që ushtron (në SHBA, speaker-i i Senatit është zëvendëspresidenti i **SHBA-së**), mund të zëvendësohet më dikë tjetër gjatë kohës sa zgjatë mandati por edhe të kooptohet jashtë anëtarëve të zgjedhur (**speaker**-i Dhomës së Përfaqësuesve në SHBA), pas zgjedhjes në funksion, mund të jetë politikisht neutral (**speaker**-i Dhomës së Ulët të Parlamentit britanik). Kryetarit të parlamentit i ndihmojnë në punë, sipas rregullit, nënkryetarët e zgjedhur nga mesi i opozitarëve dhe pushteteve. Kryetari parlamentit ka zyrën e vet, që i ndihmon në punët operative. Sekretariati/kancelaria kryen punën profesionale dhe administrative në parlament dhe me të udhëheq sekretari apo kancelari.

Nga udhëheqësit e parlamentit, më i njohuri dhe më i afirmuari është **speaker**-i i Dhomës së Përfaqësuesve të Parlamentit britanik, i cili shtjellohet në rreshtat në vijim. Ai këtë funksion e kryen si personalitet jashtëpartiak, pa çka që si përfaqësues është zgjedhur në njësinë e vet zgjedhore si kandidat i partisë politike. **Speaker**-i në punën e tij duhet të tregoj neutralitet politik, transparencë, **ç**iltërsi, dije dhe njohuri të procedurave dhe shpirtit të parlamentit dhe, sipas nevojës, nga pak edhe sens për humor. Atij i përkulen përfaqësuesit, para hyrjes në sallë dhe pas daljes nga ajo. Me rastin e udhëheqjes me seancat, ai duhet të ketë sens për atë se kur duhet të vazhdohet e kur të ndërpritet debati dhe duhet të jetë i rreptë në këtë pikë, por njëkohësisht edhe njerëzor që mos të vije deri te dyshimi në objektivitetin e tij. Autoritetin e pakontestueshëm të **speaker**-it e ndërton edhe dukja e tij e jashtme: tradicionalisht mban parukë, si simbol të paanshmërisë, pelerinën e zezë dhe pantallonat e shkurtër, që ia ruajnë imazhin para anëtarëve të parlamentit.

Trupat punuese (komisionet/komitetet) të parlamentit nuk janë organe të posaçme dhe të pavarura të pushtetit, por një formë e punës parlamentare përmes të cilëve ngrihet cilësia e akteve të parlamentit. Anëtarët e trupave parlamentare i zgjedh kryetari parlamentit, vetë parlamenti ose komisioni

i veçantë. Përbërja e trupave punuese synohet të plotësohet në proporcion me përfaqësimin partiak në parlament. Në trupat punuese përgatiten, shqyrtohen dhe përmirësohen propozimet e ligjeve. Kjo është e mundur për shkak se në **komisione parlamentare** ekziston ndarja sektoriale e punëve sipas fushave dhe profesioneve: anëtarësimi në to bazohet në përgatitjen profesionale dhe përvojën, kurse vetë puna në to është më joformale krahasuar me seancat plenare.

Komisioni mund të punoj edhe në përbërjen e plotë parlamentare (ta zëmë, në Britaninë e Madhe, komiteti i krejt anëtarëve të Dhomës së Ulët, **Committee of the Whole House**, mban mbledhje dhe takohet kur shqyrton ligjet e rëndësishme financiare). Komisionet, sipas rregullit, nuk kanë autorizim për të vendosur për versionin përfundimtar të ligjit të propozuar. Mund të kenë **iniciativën ligjvënëse**, kurse në disa vende edhe miratojnë ligjet e një rëndësie më të vogël (**Italia**, **Spanja**). Trupi punues ka edhe funksionin kontrollues, sepse është e lidhur për ministrinë apo resorin përkatës të ekzekutivit (komisioni për arsim – ministria arsimit etj.), propozim-ligjet e së cilës i shqyrton dhe kontrollon.

Trupat punuese të parlamentit, sipas kohës së punës dhe kohëzgjatjes së tyre, ndahen në **permanente** dhe të **përkohshme** (ad hoc). **Trupat e përhershme parlamentare** nuk kanë lidhje me detyrën konkrete të përkohshme, që lind në një moment, por kanë të paracaktuara kompetencat e tyre dhe jetojnë sa vetë parlamenti. **Trupat e përkohshme parlamentare** punojnë për një kohë të caktuar, në lidhje me një punë konkrete ku zakonisht duhet të hetohet ose hulumtohet diçka. Numri i trupave të përhershëm të parlamentit ndryshon, nga tre në **Lihtenshtajn** deri në tridhjetenjë në **Holandë**. Mes tyre veçohet, në njërën anë, trupi legjislativ, kurse në tjetrën trupat tjerë parlamentarë. Trupi legjislativ kontrollon formën e propozimit të ligjit dhe pjatueshmërinë e tij me ligjin, të drejtën ndërkombëtare dhe përgjithësisht me sistemin e brendshëm juridik. Trupat tjerë amë janë formacione n**ë** raport simetrik me ministritë përkatëse, sepse puna e tyre ka të bëj me materien e caktuar, fushën e dhënë q**ë mbulohet nga dikasteri qeveritar** (ta zëmë, komisioni/komiteti për bujqësi, për politikë të jashtme, për polici dhe kështu me radhë). Anëtarët e tyre mund të jenë, përjashtimisht, edhe individë nga jashtë nga radhët e ekspertëve të fushës së caktuar. Kriteri i parë, megjithatë, për anëtarësim në trupat amë është përkatësia partiake, kurse më pastaj, në rend të dytë, vjen ekspertiza.

Grupet parlamentare (klubet, fraksionet, etj.) janë pjesë e organizimit të brendshëm të parlamentit, të përbërë nga përfaqësuesit e një ose më shumë partive politike që janë në koalicion. Me rregulloren e punës përcaktohen kushtet për formimin e grupit parlamentar në numër absolut (ta zëmë, 20 në Francë) ose në përqindje nga numri përgjithshëm i përfaqësuesve (5 % në Gjermani). Grupet parlamentare marrin pjesë në punën e parlamentit, në rend të parë kanë rol procesual – posedojnë një kohë të caktuar për përgatitjen dhe shqyrtimin e propozim-ligjeve. Grupet parlamentare gjithashtu organizojnë dhe udhëzojnë deputetët e vet mbi paraqitjet gjatë debateve në parlament, mënyrën e votimit etj. Këto formojnë rolin material, apo rolin joprocesual, të grupeve parlamentare. Kjo tregon se grupet parlamentare janë, sipas natyrës së tyre, dorë e zgjatur e partisë politike ose koalicionit të ndara si njësi të veçanta, më shumë se pjesë e pavarur e parlamentit. Është interesante se në **Dhomën e Ulët** në **Britani të Madhe** nuk ka grupe parlamentare, por deputetët disiplinohen përmes kujdestarëve partiakë, të njohur si **kamxhikët** ("whips"), të cilët përcjellin fjalimet, debatet, shqyrtimet dhe kujdesen që në fund deputetët të votojnë sipas marrëveshjes së brendshme partiake. Grupet parlamentare **mund të jenë të veçanta** për nga përbërja e tyre dhe qëllimet që synojnë: të tilla janë ato që përbëhen nga grupet e deputetëve të shumicës në pushtet dhe opozitës që kanë lënë grupet e tyre parlamentare, pastaj grupet parlamentare të grave (ta zëmë, **Lituania**) ose grupet që përbëhen nga deputetët e pakicave të ndryshme nacionale dhe të tjera.

2.6. Mënyra e punës dhe vendosjes

Parlamenti mban **mbledhje të rregullta** dhe **mbledhje të jashtëzakonshme**. Një mbledhje përbëhet nga disa **seanca**, e cila zhvillohet sipas rendit të miratuar të ditës që ka më shumë pika, shumë rrallë vetëm një.

Pas zgjedhjeve formohet parlamenti i ri, në seancën konstituive. Përveç seancës konstitutive thirren edhe seanca të tjera të veçanta – seancat në të cilat shpallet kushtetuta, seancat në të cilat përfaqësuesve iu drejtohet shefi shtetit, përfaqësuesi i shtetit tjetër apo organizatës dhe kështu me radhë. Krahas këtyre mbahen edhe seancat e trupave të tjerë të parlamentit (komisioneve, komiteteve, kolegjiumeve etj.), si dhe seancat e grupeve parlamentare. Koha e mbledhjeve të parlamentit përcaktohet me kushtetutë, gjë që tregon shumë për autonominë e parlamentit dhe punës së tij. Dispozita të detajuara mbi mbledhjet rregullohen me ligj, rregulloren e punës së parlamentit apo me akt të veçantë që miratohet çdo vit (siç është rasti, ta zëmë, me **Britaninë e Madhe**).

Mbledhja e rregullt e parlamentit zgjat disa muaj, zakonisht nga gjashtë deri në nëntë (ta zëmë, Austria, Belgjika) ose më shpesh; parlamenti takohet dy herë në vit në intervale të shkurtra, zakonisht nga tre muaj, nga pranvera në verë (ta zëmë, Franca dhe shumë vende të tjera). Në parlamentet dydhomëshe, dhomat mblidhen njëkohësisht, por punojnë dhe marrin vendime në **seanca të ndara**. Shembujt kur dhomat kanë **seanca të përbashkëta** janë: drejtimi Presidentit të SHBA-së mbi gjendjen e kombit, shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme në Austri, seanca e parë në Britaninë e Madhe dhe kështu me radhë. Mesatarja vjetore e ditëve të punës së parlamentit në vendet evropiane është njëqind ditë (në Britaninë e Madhe rreth 170 ditë), kurse në vit më së shumti 250 ditë (në Britaninë e Madhe). Sot përbën përjashtim situata e përcaktuar me kushtetutë e parlamenteve në **mbledhje permanente** (të përhershme). Kjo situatë zakonisht lidhet me **gjendjen e jashtëzakonshme**. Mbledhjet e përhershme të parlamentit kanë ekzistuar në disa vende edhe në kushtet e rregullta të funksionimit të shtetit (ish-Bashkimi Sovjetik, ish-Jugosllavia komuniste, republika e katërt franceze etj.). Seanca e mbledhjes së rregullt e parlamentit nis me konstatimin e rendit të ditës.

Mbledhja e jashtëzakonshme është puna e parlamentit jashtë kohës së paraparë për mbledhje të rregullt. Mbledhja e jashtëzakonshme, përkatësisht një seancë e jashtëzakonshme caktohet atëherë kur pa shtyrje duhet të nxirret një akt juridik ose të merret ndonjë vendim politik. Ajo caktohet me kërkesën e një numri të caktuar të deputetëve (e pesta, e katërta, e treta e krejt numrit të përgjithshëm të anëtarëve të parlamentit), me kërkesë të ekzekutivit ose të shefit të shtetit. Rendi i ditës këtu caktohet paraprakisht, në mënyrë që deputetët të jenë me kohë të njoftuar dhe, sado-kudo, të arrijnë të përgatiten për temat që do të diskutohen dhe shqyrtohen. Një formë e posaçme e mbledhjes së jashtëzakonshme është mbledhja e parlamentit pa ftesë, në kohë lufte, e kërcënimit të drejtpërdrejtë me luftë ose rrezikut nga lufta si dhe gjendjes së jashtëzakonshme tjetër në kuptimin e gjerë të fjalës. Kjo do të ndodhë vetëm atëherë kur përfaqësuesit në këto kushte të veçanta dhe specifike arrijnë të mblidhen dhe takohen.

Vendimmarrja më e rëndësishme e parlamentit është në seancën plenare të të gjithë përfaqësuesve. Për vendimmarrje në seanca plenare nevojitet prania e një numri të caktuar të anëtarëve të parlamentit apo **kuorumi**. Këtë e përbëjnë, zakonisht, shumica e numrit të përgjithshëm të parlamentit. Vendimet merrem më **shumicë të kualifikuar** (dy të tretat, pesë të tretat), **shumicë absolute** (mbi gjysmën) dhe **me shumicë të thjeshtë** (relative), me kusht që në seancë në kohën e vendosjes gjenden më shumë së gjysma e anëtarëve të parlamentit. Ne parlamentet bashkëkohore, shumica e thjeshtë është standardi themelor i vendimmarrjes, mbi të gjitha për të lehtësuar nxjerrjen e ligjeve dhe evitimin e osbtruksionit të opozitës. Vendosja me shumicë absolute dhe të kualifikuar është më e rrallë dhe ka të bëj me situatat kur votohet buxheti, zgjidhet dhe ndryshohet qeveria, zgjidhen kuadrot (zyrtarët publikë), miratohet kushtetuta dhe kështu me radhë.

Në fillim të seancës vendoset për rendin e ditës, renditjen e temave mbi të cilat parlamenti do të shqyrtoj, debatoj dhe vendos. Rendin e ditës mund ta caktoj qeveria, kryetari i parlamentit ose deputetët. Lidhur me ruajtjen apo mbajtjen e temës në rend të ditës, kohëzgjatjen e debatit dhe shqyrtimit lidhur me disa propozime, ekzistojnë zgjidhje të ndryshme. Në të **drejtën anglo-saksone** vlen liria e pakufizuar e fjalës në parlament, ashtu që deputeti nuk ka nevojë që të mbahet rreptësisht për temën e rendit të ditës në paraqitjen e vet, as të kufizohet në pikëpamje kohore. Liria e pakufizuar e fjalës është parim rregullativ i jetës parlamentare, në sistemin anglo-sakson edhe për faktin që, në situata të caktuara, debati mund të mbyllet përnjëherësh (“gilotina” në Parlamentin britanik), përkatësisht fjalimi i përfaqësuesit konkret mund të ndërpritet

(me vendimin e dy të tretave të anëtarëve prezentë të Senatit të SHBA-së, vendimin e speaker-it në Indi dhe kështu me radhë). Në **Evropën kontinentale** ekzistojnë rregulla të rrepta lidhur me kohën dhe temën objekt debati e shqyrtimi në parlament, me qëllim të ngritjes së efikasitetit të punës së organit përfaqësues. Koha për debat është e përcaktuar me rregulloren e punës dhe nuk mund të këtë paraqitje jashtë temës, çfarëdo qoftë, për çka kujdeset kryetari i parlamentit ose kryesuesi. Për këtë qëllim, kryetari i parlamentit mund t'ia merr fjalën deputetit. Në anën tjetër, duhet të mundësohet që edhe pakica politike të parashtroj dhe argumentoj kundër akteve që zakonisht i propozon ekzekutivi.

Një mjet legal me të cilin shërbehet opozita gjatë debateve parlamentare është instituti i njohur si **obstruksioni** (ang.: **filibuster**). Ky përfaqëson përpjekjen e opozitës për të shtyrë dhe, në instancë të fundit, edhe pamundësuar nxjerrjen e ndonjë ligji ose zgjedhjen e ndonjë zyrtari publik. Në këtë kuptim, më të përshtatshmet janë fjalimet me orë të tëra të deputetëve lidhur me një pikë të rendit të ditës (më së gjati është mbajtur fjalimi në Senatin e SHBA-së në vitin 1957, kur për 24 orë të tëra kanë folur 23 senatorë). Opozita mund të pengoj punën e parlamentit duke paraqitur numër të madh të amendamenteve në propozimligjin apo në kushtetutë, siç ka qenë, ta zëmë, rasti në Francë në vitin 2016, kur janë paraqitur 137.449 amendamente në një propozim-ligj, ose në mënyrë krejtësisht specifike, siç është ecja e ngadalësuar deri te kutia e votimit, siç ka qenë rasti në Japoni në vitin 1992, kur për një vendim është votuar 11 orë të tëra).

Teknikat e votimit në seancë janë të ndryshme: me ngritje dore, me fletëvotim, shtypjen e tastierës me përdorim të kartës së identifikimit. Teknika e fundit është më e përhapura dhe paraqet mënyrën bashkëkohore të votimit në parlament, megjithatë jo më e përkryera sepse shpesh vjen deri të shpërdorimi i kartave të identifikimit.

2.7. Procedura e ligjvënies

Procedura e ligjvënies përbëhet nga disa faza në të cilat ndërmerren veprime juridike me qëllim të nxjerrjes së ligjit. Procedura ligjvënëse në fakt është forma e caktuar për miratimin e ligjit, për përkthimin e politikës në formën e normës. Forma është, siç e ka thënë juristi i mirënjohur gjerman, **Rudolf Jering** (Caspar Rudolph Ritter von Jhering: 1818-1892), motra binjake e lirisë dhe armiku i përbetuar i arbitraritetit.[57] Procedura ligjvënëse është më e rëndësishmja ndër krejt procedurat që zhvillohen në parlament, nga shkaku se ligjvënia është kompetenca themelore e parlamentit. Ligjet prodhohen brenda kufijve të përcaktuar nga sipër me kushtetutë, kurse nga poshtë me urdhrat e pushtetit ekzekutiv.

Procedurën e ligjvënies si tërësi nuk e zbaton parlamenti, por ai ka rolin qendror sepse i takon faza fundamentale – shqyrtimi dhe vendosja. Nga fillimi deri në mbarim, procedura e ligjvënies është e ndrydhur me organet e pushtetit ekzekutiv – qeverinë si propozuesin dhe shkruesin më të madhë të ligjeve, dhe në fund vjen shefi i shtetit që shpall ligjet dhe mund të këtë të **drejtën e vetos**. Në parlament kritikohet propozimi i ligjit, paraqiten amendamentet në ligjet e propozuara ose mbrohet teksti i propozuar i tyre, me qëllim parësor që opinioni të njoftohet me propozimet, pra jo për shkak se shqyrtimi i propozimeve do të jetë frytdhënës dhe do të përmirësoj tekstin fillestar të ligjeve. U mor vesh, fjalën e fundit për tekstin e ligjeve të propozuara e jep shumica parlamentare, e njëjta shumicë që mbështet qeverinë.

Disa procedura të ligjvënies rregullohen me **kushtetutë** (ta zëmë, e drejta e iniciativës ligjvënëse, shpallja e ligjeve), kurse dispozitat më të detajuara gjenden në **ligj.** Numri më i madh i çështjeve lidhur me procedurën e ligjvënies normohet nga vetë parlamenti me **rregullat e tij brendshme**, përkatësisht me rregulloren e punës. Procedura e ligjvënies mund të jetë **njëshkallëshe**, **dyshkallëshe** dhe **trishkallëshe**, në varësi të asaj se sa lexime i ka një projektligj. Një lexim i draftligjit nënkupton që ai hyn në procedurë

[57] Robert S. Summers, "The Place of Form in the Fundamentals of Law" (2001). *Ratio Juris* Vol. 14 No. 1 (March 2001), fq. 106-129 në fq. 126.

parlamentare, shqyrtohet dhe votohet. Nëse vetëm një herë votohet për draftligj, atëherë bëhet fjalë për procedurën njëshkallëshe të ligjvënies. Kur ka më shumë lexime të draftit të ligjit, bëhet fjalë për procedurën shumëshkallëshe dhe propozimi mund të rrëzohet në çdo fazë të leximit.

Më arritjen e projektligjit në parlament, kryetari i tij e dërgon atë në trupat kompetente të parlamentit, deputetëve dhe qeverisë (nëse ajo nuk është propozues i tij). Më pas kalohet në shqyrtimin e tekstit në parim, në detaje dhe, në fund, votohet. Kur procedura ligjvënëse zhvillohet në dy ose tri lexime, propozimi i parë i ligjit përmban vetëm parimet themelore apo idetë që ligji duhet t'i trajtoj. Në lexim të parë, fazë e rëndësishme e procedurës së ligjvënies është shqyrtimi publik i projektligjit, në të cilën opinioni publik, veçanërisht komuniteti profesional, kyçet në diskutimet lidhur me tekstin e tij. Leximi i dytë është propozimligji i përpunuar në detaje, që futet në procedurën e ligjvënies – kalon shqyrtimin në trupat e parlamentit dhe në seancë plenare, pastaj kalon në votim. Nëse ligji prodhohet në tri lexime, atëherë vetëm në fazën e tretë propozimligji dorëzohet në parlament në versionin përfundimtar të tij, në formën e përcaktuar dhe me normat me përmbajtje të detajuar.

Faza e parë e ligjvënies, e prodhimit të ligjit, është **faza e propozimit** të tij. Kjo quhet ndryshe edhe si **iniciativa ligjvënëse** Këtë fazë parlamenti e ndan me subjektet tjera. Përveç deputetëve, të drejtën e iniciativës ligjvënëse e kanë edhe qeveria, votuesit, shefi shtetit, avokati popullit, guvernatori, organi akuzës, komunat/bashkitë, njësia federale (parlamenti ose ekzekutivi i saj), këshillat/komisionet parlamentare, grupet parlamentare, si dhe trupat e veçanta siç është rasti me këshillin ekonomiko-social në **Itali**. E drejta e **iniciativës legjislative** e deputetëve mund të jetë **individuale** ose **kolektive**. Rasti më i shpeshtë është që vetë deputetët si individë mund të paraqesin një propozimligj ose amendamente në të (Italia). Në rastin e dytë, propozimi i një përfaqësuesi duhet të mbështetet nga më shumë përfaqësues të tjerë (ta zëmë, në Austri – 5 përfaqësues, në Poloni – 15 ose komisioni parlamentar, në Gjermani 5 % e anëtarëve të Bundestagut ose një grup parlamentar). Përfaqësuesit si propozues të ligjit, me këtë edhe vetë parlamenti janë, megjithatë nën hijen e ekzekutivit. Deputetët, në të vërtetë, çdo herë e më rrallë paraqiten si propozues të ligjeve, sepse nuk mund të kundërvihen ndaj ekzekutivit për sa i përket profesionalizmit të kërkuar për shkrimin e ligjit, as sa i përket votimit të suksesshëm të tekstit përfundimtar të ligjit. Me këtë vërtetohet rregulli se parlamenti bashkëkohor praktikisht çdo herë pret propozimin e pushtetit ekzekutiv për të punuar, në këtë rast për të nxjerr ligje. Kështu, ta zëmë, në parlamentin britanik, deputetët mund të propozojnë vetëm ligje private (që kanë të bëjnë me individin, grupet dhe fusha të ngushta shoqërore), që janë të një rëndësie më të vogël, jo edhe ligje publike me të cilat rregullohen çështjet më të rëndësishme shoqërore (raporti i individit me shtetin, e drejta kushtetuese, e drejta administrative dhe e drejta penale).

Qeveria është propozuesi më i rëndësishëm dhe më i shpeshtë i ligjeve. Nëse merret për baza shpeshtësia e ligjeve të miratuara, mund të thuhet se ekzekutivi ka gati në tërësi monopolin e iniciativës ligjore, mbi 90 % të tyre i propozon vetë ai. Edhe juridikisht, ekzekutivi ka pozitën më të favorshme si propozues i ligjeve, nga shkaku se ka shërbime profesionale që mund të shkruajnë projektligje cilësore dhe të rregullta në aspektin nomo-teknik. Përveç kësaj, ekzekutivi ka më shumë autorizime në procedurën ligjvënëse – deklarohet lidhur me propozimet e të tjerëve, ka kohë të pakufizuar për pjesëmarrje në shqyrtimet e propozimeve ligjore, disa ligje mund të propozon vetëm ai, siç është rasti i ligjit mbi buxhetin apo nëse bëhet fjalë për ligjet e një fuqie më të madhe juridike (ta zëmë, në Francë, Greqi), në emër të ekzekutivit, ligje mund të propozojnë edhe dikasteret apo resorët ministrorë.

Shefi i shtetit merr pjesë në fund të procedurës ligjvënëse, por edhe mund të ketë të drejtën e iniciativës ligjore (Hungaria, Polonia, Rusia). Është shumë interesant se, edhe në vendet ku udhëheq me qeveri (Franca), përkatësisht ku shefi shtetit është njëkohësisht shef i ekzekutivit (SHBA), shefi i shtetit nuk ka të drejtën e iniciativës ligjore, por këtë të drejtën në emër të tij e realizon qeveria ose anëtari i parlamentit.

Ligji është shprehje e **vullnetit të përgjithshëm**, ashtu që edhe qytetarët duhet të gëzojnë të drejtën e iniciativës ligjore. Në vendet ku njihet, iniciativa popullore ligjvënëse çdo herë është një e drejtë kolektive për

realizimin e së cilës kërkohet mbështetja (nënshkrimet) e votuesve, e shprehur në përqindje apo në shifra absolute (ta zëmë, në Itali kërkohen 50.000 nënshkrime). Sa më i vogël numri, përkatësisht përqindja, më demokratike e drejta e iniciativës ligjvënëse.

Propozimi i ligjit duhet të plotësoj **kushtet formale** dhe **kushtet përmbajtësore** (materiale). Rregull themelor është që propozimi duhet të jetë i shkruar në formë të normave juridike, të sistemuara në nene dhe njësi të tjera sistematizimi të tekstit ligjor. Propozimi përmban arsyet e përpilimit të tij si dhe arsyetimin e vetë tekstit si të tillë, qëllimet e supozuara që synohen të arrihen, vlerësimin e kostos, harmonizimin me sistemin juridik dhe marrëveshjet ndërkombëtare, një arsyetim i posaçëm dhe special mbi fuqinë eventuale prapavepruese të ligjit të ardhshëm (në rastet kur përcaktohet se do të ketë efekt prapaveprues) dhe, në fund, arsyet për miratim në procedurë të shkurtuar (nëse një gjë e tillë ndodh).

Faza e dytë e procedurës së ligjvënies është **faza e shqyrtimit dhe votimit mbi propozimligjin**. Para shqyrtimit dhe votimit në plenare, propozimligji trajtohet në trupat punuese të parlamentit – në këshillin/komisionin amë dhe në atë legjislativ. Këtu kryhet pjesa më e madhe e punës, sepse teksti i propozimit zakonisht shqyrtohet pa presion të publikut. Anëtarët e trupave parlamentare në fjalë i tregojnë propozuesit për të metat përmbajtësore (materiale) të propozimit, të cilat shtjellohen në trupën amë parlamentare, si dhe për të metat formale të tij, të cilat shtjellohen në trupën legjislative parlamentare. Krejt këta hapa ndërmerren në koordinim me ministritë kompetente. Në këtë fazë merren parasysh amendamentet, organizohen shqyrtimi publik dhe dëgjimi publik.

Kur propozimligji arrin në rend të ditës në parlament, një punë e madhe rreth tij tanimë është kryer, sepse ai formalisht dhe përmbajtësisht është përgatitur dhe bërë gati për miratim. Para miratimit, në diskutimin mbi propozimligjin marrin pjesë deputetët e lajmëruar për diskutim, përfaqësuesit e grupeve parlamentare, përfaqësuesi i propozimligjit, anëtarët e qeverisë (ekzekutivit). Gjatë diskutimit parlamentar si më sipër mund të kërkohet fjala lidhur me gabimet në procedurë, shkelje të rregullores së punës, që jo domosdo duhet të jenë të lidhura me temën që diskutohet.

Shqyrtimi propozimligjit mund të jetë i unifikuar dhe të përfshijë si debatin për propozimin në **parim** ashtu edhe në **pjesët e veçanta** të tij, por edhe si një shqyrtim i ndarë. Gjatë shqyrtimit në parim, propozimligji kritikohet si një rregullativë që nuk normon siç duhet dhe në tërësi fushën e caktuar, nuk mund të realizoj qëllimet e synuara, nuk përputhet me sistemin juridik dhe nuk është në pajtim me kushtetutën dhe ligjet tjera. Shqyrtimi propozimligjit në imtësira individuale i referohet debatit mbi dispozitat konkrete ligjore në të cilat janë vënë amendamente. Pas mbylljes së shqyrtimit në parim dhe në imtësira individuale, votohet për amendamentet dhe propozimligjin në tërësi. Është e mundur që, gjithashtu, për amendamentet dhe propozimin si tërësi përfaqësuesit të deklarohen më vonë, ditën e votimit, pas trajtimit të krejt pikave të rendit të ditës.

Ligjet miratohen me shumicë votash, me kusht që ekziston kuorumi për vendosje. Në parim, me shumicë nënkuptohet shumica e atyre që janë prezent, nëse prezent janë shumica e krejt deputetëve në parlament, përkatësisht **shumica e thjeshtë** apo **relative**. Mënyra e sforcuar e miratimit të ligjeve ekziston atëherë kur për propozimligj kërkohet të votojnë shumica e krejt deputetëve të parlamentit, përkatësisht **shumica absolute**. Në raste të caktuara, përjashtimisht për votim të propozimligjit mund të kërkohet një shumicë edhe më e madhe se shumica absolute, siç janë shumica e dy të tretave, tri të pestave, dhe kjo quhet **shumicë e kualifikuar**. Kjo shumicë, si rregull, kërkohet për miratim të kushtetutës dhe amendamenteve kushtetuese, jo të ligjeve. Nëse me kushtetutë përcaktohet një gjë e tillë, atëherë propozimligji mund të nxirret në referendum, në mënyrë që për të të deklarohen qytetarët për të konfirmuar ose rrëzuar të njëjtin.

Faza e shqyrtimit dhe votimit është më e komplikuar dhe zgjat më shumë në parlamentin dydhomësh, në veçanti nëse **dhoma e lartë** ka kompetencë ligjvënëse. Nëse vetëm **dhoma e ulët** ka kompetenca ligjvënëse, siç është rasti, ta zëmë, në Britani me ligjet financiare, procedura është e njëjtë si në parlamentin

njëdhomësh. Nëse dhoma e lartë ka vetëm të drejtën e vetos në ligjin e votuar në dhomën e ulët, atëherë procedura e ligjvënies zgjat më shumë, mirëpo për ligjin, në fund, vendos dhoma e ulët (rasti i Francës). Një situatë tjerë ekziston kur, në procedurën e prodhimit të ligjeve, dy dhomat janë të barabarta: në një rast të tillë, propozimligji duhet të miratohet në tekst të njëjtë në dy dhomat. Nëse ky nuk është rasti për shkak se, ta zëmë, një dhomë ka ndryshuar tekstin me amendament konkret, fillon procedura e zgjidhjes së kolizionit mes dhomave. Me qëllim të tejkalimit të dallimeve në ligjet e miratuara, mund të formohet një komision në të cilin hyjnë përfaqësuesit e dy dhomave. I tillë është rasti, ta zëmë, në Gjermani, Francë, SHBA, ku komisioni formuar për qëllimet e tejkalimit të kolozionit provon që, brenda një kohe të caktuar, të harmonizoj tekstet ligjore. Ekzistojnë edhe mënyra të tjera të zgjidhjes së kolizionit mes dhomave: votim i përbashkët i dy dhomave (Norvegjia), "shëtitjen" e ligjit nga një dhomë në tjetrën (Italia), mbivotimi i ndryshimeve të votuara në dhomën e lartë (Britania Madhe, Gjermania, Spanja), si dhe shpërndarja e parlamentit.

Faza e tretë në prodhimin e ligjeve është **faza e shpalljes së ligjit**, e pasuar nga publikimi dhe hyrja në fuqi. Të drejtën e shpalljes së ligjit e ka shefi shtetit dhe heq rrënjët nga e drejta e **monarkut anglez** për vënien e nënshkrimit në ligj me qëllim fuqizimin (sanksionimin) e tij ("King in Parliament"). Kryetari i parlamentit ia dërgon ligjin e miratuar shefit të shtetit, i cili nxjerr akt nënligjor mbi shpalljen e ligjit (dekret), vet ose me kundërfirmën e ministrit përkatës ose kryeministrit të vendit.

Shpallja e ligjit nuk është vetëm një e drejtë formale e shefit të shtetit, në rastet kur ai ka të **drejtën e vetos së thjeshtë** (suspenzive) ose **të drejtën e vetos absolute**. E drejta e vetos është një instrument juridik me të cilin përkohësisht ose përfundimisht pamundësohet hyrja në fuqi e ligjit, sepse shefi i shtetit konsideron se ai nuk është i qëlluar ose është jokushtetues, jo mjaft i mirë dhe i dobët. Në praktikë, shefi i shtetit vendos veto kryesisht kur nuk i takon opsionit të njëjtë politik me ekzekutivin dhe shumicën në parlament. Kur vendoset veto suspenzive brenda kohës së përcaktuar, atëherë ligji i kthehet parlamentit për vendosje të serishme. Nëse ligji i miratuar rivotohet sërish, me shumicë të njëjtë ose të sforcuar, atëherë ai duhet të shpallet. Kur vendoset veto absolute, ndërkaq, atëherë ajo ka karakterin e aktit përfundimtar, sepse pamundëson përfundimisht hyrjen në fuqi të ligjit të miratuar në parlament. Nisur nga fakti se kjo praktikë bie ndesh me parimin e ndarjes së pushtetit, atëherë është e kuptueshme se përse ky lloj i vetos nuk haset në vendet ku organet e pushtetit janë të organizuara sipas këtij parimi. Një formë e veçantë e **vetos absolute** është e a.q. **vetoja e xhepit** ("pocket veto"), e cila është një manovër legjislative që i jep të drejtën presidentit të ushtroj të drejtën e vetos ndaj një propozimligji duke mos ndërmarrë asnjë veprim (duke e mbajtur në "xhep" të drejtën e vetos) dhe duke rrëzuar efektivisht propozimin pa ushtruar të drejtën e vetos afirmativisht. Nga zgjidhjet kushtetuese e ligjore të vendeve të ndryshme varet nëse ekziston një e drejtë e tillë, siç janë, ta zëmë, zgjidhjet në **Indi**,[58] **SHBA**[59] etj., të cilat njohin një të drejtë të tillë. Vlen të theksohet se standard më

[58] Neni 111 i **Kushtetutës së Indisë** (1949) përcakton që presidenti shpall një ligj të miratuar nga dy dhomat e parlamentit ose mban (nuk jep) pëlqimin e vet për një gjë të tillë, por mund edhe të kthej të njëjtin në parlament për rishqyrtim. Cf. **The Constitution of India** [As on 1st April, 2019]. Në internet: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://legislative.gov.in/sites/default/files/COI-updated.pdf (shikuar më 26 nëntor 2022); Nëse presidenti kthen ligjin e miratuar dhe parlamenti e miraton serish, me ose pa amendamente, atëherë presidenti nuk mund të mbaj (mos e jep) pëlqimin. Kushtetuta, megjithatë, nuk përcakton ndonjë kohë specifike deri kur presidenti duhet të veproj lidhur me ligjin e dërguar nga parlamenti. Mungesa e një kuadri kohor brenda të cilit shefi indian i shtetit duhet të deklarohet për ligjin bën që, nëse presidenti nuk jep pëlqimin e vet, ligji i miratuar në parlament mos të hyj në fuqi kurrë. Kjo nënkupton se nga një veto suspensive, ajo kthehet në një **veto absolute të xhepit**. Cf. Brij Kishore Sharma, *Introduction to the Constitution of India* (Prentice – Hall of India: New Delhi, 2007), fq. 145.

[59] Nëse presidenti nuk e shpall ligjin e miratuar brenda 10 ditëve, kurse Kongresi në ndërkohë kryen seancën (nuk është në mbledhje), ligji praktikisht është refuzuar (rrëzuar). Nëse insistohet që, megjithatë, të miratohen zgjidhjet e miratuara ligjore që janë refuzuar me veton e vendosur, propozimi i ri i ligjit duhet serish të kaloj të gjitha fazat e procedurës së ligjvënies. Kjo përcaktohet me dispozitën e nenit I (seksioni 7) të **KAm**. Në këtë kuptim vlen të përmendet rasti i presidentit **F. D. Ruzvelt** (*Franklin Delano Roosevelt: 1882-1945*) që ka penguar hyrjen në fuqi të 263 ligjeve. Cf. George C. Robinson, "The Veto Record of Franklin D. Roosevelt" *The American Political Science Review* Vol. 36, No. 1 (Feb., 1942), fq. 75-78; Presidentët tjerë, ta zëmë, **Bill Klinton** (Bill Clinton), **Xhorxh Bush** (Georg W. Bush) **Barak Obama** (Barack Obama) kane vetëm nga një pengesë në ligje. Cf. më shumë

i përgjithshëm kushtetues është që, nëse presidenti nuk ndërmerr veprim për shpallje të ligjit dhe as nuk ushtron veton ndaj tij, atëherë ai bëhet ligj. Sikundër shihet, pra, këtu bëhet fjalë **veto suspenzive** që mund të ketë efekt absolut.[60]

Pas shpalljes, ligji publikohet ashtu që qytetarët të ketë mundësi informimi mbi dispozitat e tij dhe harmonizim të sjelljes së tyre me te. Të gjitha ligjet botohen në gazetën zyrtare të shtetit (gazeta zyrtare ose forma të tjera të publikimit të ligjeve dhe akteve të tjera të përgjithshme që nxjerr parlamenti). Ligji hyn në fuqi me kalimin e një kohe të caktuar nga dita e publikimit, e njohur si **vocatio legis**, që mund të jetë tetë, nëntë, pesëmbëdhjetë, tridhjetë ditë. Përjashtimisht dhe për shkaqe të arsyeshme dhe të përcaktuara me ligj, mund të hyj në fuqi edhe ditën e publikimit. Në ligj mund të përcaktohet në mënyrë të veçantë që disa dispozita të tij hyjnë në fuqi më vonë, ashtu që për një kohë të caktuar shtyhet zbatimi i tyre (gjysmë viti, një vit etj.). Më rrallë përcaktohet mundësia e shtyrjes së zbatimit të krejt ligjit që formalisht ka hyrë në fuqi.

Ligji vlen për të ardhmen (**ex nunc**), sepse rregullon të drejtat e detyrimet nga koha e miratimit të tij, përkatësisht nga koha e hyrjes në fuqi e tutje. Në disa raste, ligji mund të vlej me prapaveprim (**ex tunc**), zbatohet për të kaluarën, pra normon marrëdhëniet juridike që janë krijuar para hyrjes së tij në fuqi. Kështu, ta zëmë, zbatohet ligji penal më i favorshëm për kryesin e veprës penale. Disa ligje çdo herë kanë efekt prapaveprues, ta zëmë ligji për amnistinë apo ligji për restituim të pasurisë. Efekt prapaveprues kanë edhe ligjet që miratohen për situata të veçanta, siç janë, ta zëmë, ligjet për marrjen e pasurisë dhe ekstrafitimit të fituar në mënyrë kundërligjore, për pranimin e rezultateve zgjedhore, për konsolidimin financiar të afarizmit të subjekteve ekonomikë etj.

Sipas rregullit ligji miratohet për kohë të pacaktuar. Nëse ligji miratohet me qëllim që të vlej në kohë të përcaktuar që më parë, atëherë me kalimin e saj kohe ai pushon së vlejturi. Meqë zakonisht nuk ekziston një kohë për vlefshmërinë e ligjit, ai vlen për aq sa nuk miratohet (nxirret) një tjetër ligj më vonë që rregullon materien e njëjtë. Kjo vë në lëvizje parimin juridik **lex posterior derogat lex priori**. Një situatë e posaçme krijohet kur nxirret kushtetuta e re dhe lihet një kohë brenda së cilës ligjet duhet të harmonizohen me të. Me kalimin e kësaj kohe të përcaktuar me kushtetutë, ligjet e paharmonizuara me të humbin fuqinë e tyre juridike. U mor vesh, praktika e shteteve është e ndryshme dhe ka raste kur vendet tolerojnë vlefshmërinë e ligjeve të paharmonizuara edhe për një kohë pas nxjerrjes së kushtetutës së re.

2.8. Shpërndarja e parlamentit

Përbërja e parlamentit jeton aq sa është mandati i plotë, që zakonisht është katër ose pesë vite. Mandati i parlamentit mund të shkurtohet nëse organi i pushtetit ekzekutiv vendos për shpërndarjen e tij. Kjo e drejtë devijon nga ndarja e ngurtë e pushtetit dhe paraqet pjesë të baraspeshës në sistemin parlamentar të pushtetit, sepse parlamenti mund të ndryshoj (zëvendësoj) qeverinë dhe shkarkoj (largoj) presidentin e republikës. Në sistemin presidencial të ndarjes së pushtetit, pushteti ekzekutiv nuk mund të shpërndaj parlamentin. Kjo ka vlejtur edhe në sistemin e unitetit demokratik të pushtetit, përkatësisht në sistemin e kuvendeve, në të cilat trupi përfaqësues ka qenë mbi organet tjera të pushtetit.

Historikisht shikuar, e drejta për shpërndarje ka origjinën e vet në parlamentet mesjetare të vendeve të Evropës, të cilët shërbenin si trupa ndihmës dhe këshillëdhënës të monarkëve, nxirrnin ligje dhe vinin taksa. Përkundër që ekzistonin parlamente që mblidheshin rregullisht dhe që mund të shpërbëheshin vetëm me pëlqimin e tyre, në të shumtën e rasteve ato mblidheshin dhe shpërndaheshin me vullnetin e

në portalin: *The American Presidency Project*, "Pocket Veto", në internet: https://www. presidency.ucsb.edu/documents/app-attributes/pocket-veto?page=24 (shikuar më 26 nëntor 2022).

60 The American Presidency Project, "Pocket Veto". Në internet: https://www.presidency.ucsb.edu/documents/app-attributes/pocket-veto?page=24 (shikuar më 26 nëntor 2022).

monarkut. Megjithatë, e drejta për shpërndarje, në kuptim të konstitucionalizmit modern, për herë të parë është krijuar në Francë me **Kartën Kushtetuese** të vitit 1814. Ky dokument kushtetues evropian ka ruajtur të drejtën e gjerë dhe të pakufishme të kurorës për thirrjen dhe shpërndarjen e parlamentit francez. Ngjashëm me të kanë qenë zgjidhjet kushtetuese të kushtetutave të vendeve të tjera, siç janë: **Kushtetuta e Belgjikës** e vitit 1831, **Kushtetuta e Rumanisë** e vitit 1866 etj. Edhe **Kushtetuta e Japonisë** e vitit 1889, e modeluar sipas standardeve të konstitucionalizmit evropian të kohës, ka përcaktuar zgjidhje të njëjtë kushtetuese, përkatësisht të drejtën e kurorës perandorake të këtij vendi për shpërndarje të parlamentit në çdo kohë, për çfarëdo arsye qoftë.

Më shpërndarjen, pushteti ekzekutiv disiplinon parlamentin me një masë ekstreme, duke vënë konfliktin dhe mosmarrëveshjen mes tyre para votuesit. Qytetarët me votën e tyre tregojnë se kush nga këto dy organe kishte pasur të drejtë. Disiplinimi i parlamentit mund të bëhet edhe përmes metodave preventive, përkatësisht me kërcënim se parlamenti mund të shpërndahet ose vetë qeveria mund të jep dorëheqje.

Parlamenti shpërndahet me nxjerrjen e një akti nënligjor, **dekreti** ose **vendimi**, të cilët, për nga natyra e tyre janë akte politike, jo akte juridike. Kjo do të thotë se nxirren për arsye politike dhe nuk mund të jenë objekt i kontrollit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Nëse akti mbi shpërndarjen e parlamentit ka qenë i mirë, i arsyeshëm dhe oportun, apo i keq për qeverinë dhe krejt pushtetin ekzekutiv, tregohet në zgjedhjet parlamentare.

Përveç zgjedhjeve të reja parlamentare, pasoja e parë e drejtpërdrejtë e shpërndarjes së parlamentit është **ndërprerja e punës** së tij. Lidhur me këtë, mendimet janë të ndara mbi atë nëse fare ekziston parlamenti i shpërndarë, meqë nuk punon më? Sipas disave, nëse parlamenti nuk ushtron funksionin ligjvënës dhe funksionet tjera, ai nuk mund të ekzistojë. Sipas të tjerëve, ai ekziston potencialisht, ani pse në formë virtuale, deri në zgjedhjen e parlamentit tjetër. Me ekzistimin potencial të parlamentit të shpërndarë nënkuptohet situata e krizës së jashtëzakonshme, luftës dhe rrezikut nga lufta, çdo gjendje e ngjashme në të cilat mblidhet dhe mban mbledhje pa nevojën e të qenit i ftuar nga dikush. Në dobi të tezës së ekzistimit të parlamentit të shpërndarë shkon edhe argumenti faktik se seancën e parë konstitutive të parlamentit të ri mund ta thërras kryetari i parlamentit të shpërbërë.

Në parlamentin dydhomësh, më së shpeshti mund të shpërndahet dhoma e ulët. Nëse qeveria zgjidhet dhe përgjigjet para dy dhomave, atëherë mund të shpërndahen dy dhomat. I tillë është rasti me Italinë.

Mbi shpërndarjen e parlamentit vendos qeveria, shefi i shtetit, por mund të shpërndahet edhe sipas fuqisë së kushtetutës (**ex constitutionem**). Qeveria vendos për shpërndarjen e parlamentit në **sistemin parlamentar klasik monistik**. Ajo këtu udhëhiqet nga arsyet politike, me synim që në zgjedhje të rikthej shumicën e humbur parlamentare apo të forcojë atë dhe në këtë mënyrë të vazhdoj pushtetin e vet. Shefi i shtetit vetëm formalisht nxjerr vendim për shpërndarjen e parlamentit, praktikisht duke konfirmuar propozimin e qeverisë. Të tilla janë praktikat dhe zgjidhjet kushtetuese, ta zëmë, në Britaninë e Madhe, Belgjikë, Holandë.

Në **sistemet e përziera**, shefi i shtetit ka të drejtën e shpërndarjes së parlamentit: në sistemin gjysmëpresidencial, ai mund të bëjë këtë në çdo kohë dhe për çfarëdo arsye qoftë, ta zëmë: për shkak të ndryshimit të shumicës parlamentare, nëse nuk është i kënaqur me punën e parlamentit, nëse parlamenti është në konflikt të stërzgjatur me qeverinë dhe presidentin etj. I tillë është rasti me **Francën**, praktikën dhe zgjidhjet e saj kushtetuese.

Në sistemin e përshtatur parlamentar, apo në sistemin e racionalizuar parlamentar, shefi i shtetit shpërndan parlamentin por vetëm me propozim të qeverisë. Nuk mund të shpërndaj vetë atë, por as propozimi i qeverisë nuk e detyron për një gjë të tillë domosdo, sepse mund të shpërndajë parlamentin, por nuk

është i detyruar për një gjë të tillë. Të tilla janë praktikat dhe zgjidhjet kushtetuese, ta zëmë, në Kroaci, Serbi dhe në disa vende.

Sipas fuqisë së kushtetutës, parlamenti shpërndahet në kohë saktësisht të përcaktuar dhe për shkaqe qartësisht të vëna në kushtetutë. Më së shpeshti kjo ka të bëj me paaftësinë e parlamentit për zgjedhje të qeverisë në një afat të përcaktuar kushtetues, qoftë kur flitet për parlamentin e ri ose për atë të vjetrin që ka zgjedhur një qeveri më parë por i ka shprehur mosbesim në ndërkohë ose vetë ajo ka dhënë dorëheqje. Ekzistojnë edhe shembuj të tjerë të shpërndarjes së parlamentit **ex constitutionem**: mungesa e kuorumit për punë dhe vendosje (**Çekia** - mundet por nuk është e domosdoshme shpërndarja), shprehja e mosbesimit ndaj qeverisë në një periudhë të caktuar kohore (**Rusia**), mosvotimi i kryetarit të ri të qeverisë në kohë të caktuar (**Sllovenia**), apo rasti i vetëshpërndarjes sipas të drejtës që buron nga kushtetuta (**Austria**).

Ekzistojnë periudha kohore kur parlamenti nuk mund të shpërndahet. Në kohëra të krizave shtetërore ekziston interesi që të gjitha organet shtetërore të punojnë. Për këtë arsye parlamenti nuk mund të shpërndahet në kohë lufte dhe rrezikut të drejtpërdrejtë nga lufta ose në kohë të gjendjes së jashtëzakonshme. Një lloj i posaçëm e gjendjes shtetërore është periudha kur nuk ekziston shefi i shtetit i përcaktuar me kushtetutë, siç është rasti, ta zëmë, kur mbretëron regjenca sepse trashëgimtari i fronit është akoma i mitur ose kur në vend të presidentit të republikës është ushtruesi i detyrës. Në këto situata ndalohet shpërndarja e parlamentit derisa të zgjasin rrethanat e cekura. Ekzistojnë shembuj kushtetues kur presidenti si shef shteti nuk mund të shpërndaj parlamentin në gjashtë muajt e fundit të mandatit të vet (Rumania) ose, edhe më shpesh, shembuj kushtetues që ndalojnë shpërndarjen e parlamentit në kohën sa janë duke u zhvilluar procedurat e votimit të mosbesimit të qeverisë.

3. Kuvendi i Kosovës: historia dhe zhvillimi

Në kuptimin juridik-kushtetues, vështirë se mund të flitet për një kuvend të mirëfilltë të Kosovës deri me shpalljen e pavarësisë së parë të **Kosovës**, pas referendumit të mbajtur më 26-30 shtator 1991. Deri atëherë, për Kuvendin në Kosovë mund të flitet vetëm në kuptimin politiko-historik, me fillim që nga **Kuvendi i Lidhjes së Prizrenit** (1878), **Kuvendin e Lidhjes së Dytë të Prizrenit** (1943) dhe **Kuvendin e Bunjajt** (1944-1945). **Kuvendi i Prizrenit** i vitit 1945, u mbajt në rrethana të okupimit të tërësishëm ushtarak të Kosovës, që ishte vënën nën administrim të rreptë ushtarak, dhe nuk pati asnjë autorizim ligjvënës. Me pastaj, kuvendet që u themeluan deri në vitin 1974, jo vetëm që nuk patën asnjë autorizim ligjvënës, por edhe u sanksionuan si organe zbatuese të vullnetit të Serbisë në Kosovë, e cila atëbotë konsiderohej si pjesë integrale e Serbisë komuniste, pa asnjë identitet të mëvetësishëm juridiko-kushtetues. Kuvendet e Kosovës komuniste deri në nxjerrjen e Kushtetutës së vitit 1974 kanë pasur status të kuvendeve pa autorizime ligjvënëse, duke funksionuar si agjenci apo pushtet i deleguar i Serbisë në Kosovë në një sferë të kufizuar normative (ligje, statute, vendimet dhe akte të tjera, fuqia juridike e të cilave në tërësi varej nga Serbia). Me nxjerrjen e Kushtetutës së vitit 1974, Kosova, për herë të parë fiton organin e vet ligjvënës, me autorizime origjinale ligjvënëse në sferat që kishin të bënin me **Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës** (KSAK), e cila, ani pse ishte pjesë përbërëse e **Republikës së Serbisë**, gëzonte një autonomitet të plotë legjislativ në fushat e caktuara. Ato fusha, përveç sigurimit shtetëror, thuajse ishin identike me ato të republikave socialiste që ishin njësi të plota federale të ish-Jugosllavisë komuniste (RSFJ).

Kuvendi i Kaçanikut, në kuptimin **formalo-juridik** ka qenë vazhdimësi e **Kuvendit të KSAK**, i cili u shndërrua në **Kuvend të Republikës së Kosovës**, pas shpalljes së pavarësisë së parë, që u ngjiz me Deklaratën e 2 korrikut 1990 dhe u kurorëzua në referendumin e shtatorit të vitit 1991. Edhe kuvendet e ish-republikave jugosllave komuniste kanë ndjekur të njëjtën rrugë. Në fakt, **Kosova** ka ndjekur shembullin e Sllovenisë dhe Kroacisë, siç kanë bërë edhe **Bosnjë-Hercegovina** dhe **Maqedonia e Veriut**. **Kuvendi i Kaçanikut** ka pasur kompetenca të plota për kushtetutëbërje dhe ligjvënie. Pozita e tij rregullohej me **Kushtetutën e Kaçanikut** (KKaç) (nenet 96-106). Në nenin e saj 96, **KKa**ç e definonte Kuvendin e Re-

publikës së Kosovës si organ i pushtetit ligjdhënës. Tërë kohën e tij, ky organ ka vepruar në ekzil, njëjtë sikur ekzekutivi i vendit. Pas instalimit të administratës ndërkombëtare të **OKB**-së në Kosovë, **UNMIK**, Kuvendi i Kaçanikut, së bashku me Qeverinë e Kosovës, u kthyen në Kosovë por nuk u njohën si struktura legjitime nga ndërkombëtarët. Seancën e fundit, **Kuvendi Kaçanikut** e ka mbajtur pas hyrjes së trupave të **NATO**-s në Kosovë (10 qershor 1999), për të shpallur më pas shpërbërjen e vetvetes.[61]

Kuvendi i Kosovës, që shpalli **pavarësinë e dytë** dhe aktuale të vendit, më datën 17 shkurt 2008, nuk paraqet kontinuitet të **Kuvendit të Kosovës** të themeluar sipas **Kornizës Kushtetuese të Kosovës**, dokument që kishte formën e rregullores së **UNMIK**-ut, administratës ndërkombëtare që u instalua në Kosovë më 10 qershor 1999 nga OKB. **Kuvendi i Kornizës** ka pasur 120 deputetë dhe ka pasur autorizime ligjvënëse, por jo të plota, sepse autoriteti i fundit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor në vend ishte **Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm** (PSSP) të OKB-së, bazuar në **Rregulloren e UNMIK**-ut nr. 1/1999 të datës 25 korrik 1999. Me mendimin këshillëdhënës të **Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë** (GJND) të datës 22 korrik 2010, u definua statusi jo vetëm i Kuvendit të Kornizës, por edhe i krejt rendit juridik në Kosovë që u krijua sipas autorizimeve të **PSSP-së**, bazuar në Rregulloren e UNMIK mbi ligjin e zbatueshëm No. 24/1999 të datës 12 dhjetor 1999. Tani, me mendimin këshillëdhënës, **Kuvendi i Kosovës** që shpalli pavarësinë u cilësua si kuvend që kishte shprehur pushtetin origjiner konstituiv të popullit të Kosovës, jashtë rendit juridik ndërkombëtar të krijuar më 10 qershor 1999.

3.1. Zgjedhja, madhësia, struktura, përbërja dhe legjitimiteti

Pozita e **Kuvendit të Kosovës** rregullohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (**KKos**), kapitulli IV (nenet 63-82). Për dallim nga disa vende fqinje, nuk ekziston një ligj organik i veçantë që normon organizimin dhe funksionimin e Kuvendit të Kosovës. Me **KKos** rregullohen çështjet më të rëndësishme lidhur me këtë organ të rëndësishëm kushtetues: zgjedhja dhe pozita e deputetëve, mandati, të drejtat dhe detyrat, marrëdhëniet me organet tjera të pushtetit, në ndërkohë që me **Rregulloren e Punës** (RPKos) përpunohen dhe deri diku edhe përsëriten dispozitat kushtetuese si të kapitullit si më sipër. Dispozitat e **RPKos** kanë të bëjnë me rregullimin e organizimit dhe të procedurës së punës së Kuvendit.

Deputetët zgjidhen në zgjedhje të lira dhe të drejtpërdrejta, bazuar në të drejtën e përgjithshme dhe të barabartë të votës, si njëra prej të drejtave zgjedhore të rëndësishme. Kjo do të thotë se qytetarët lirshëm orientohen dhe vendosin nëse do të dalin në zgjedhje, kujt t'ia japin votën dhe, për më tepër, nëse ata vetë do të jenë kandidatë në zgjedhje. Kjo është cilësia e zgjedhjeve të lira. Krahas kësaj, ekzistojnë edhe disa cilësi të tjera të së drejtës për votë: në kushte të njëjta e drejta e votës është një e drejtë e barabartë për të gjithë, çdo votë ka vlerën e njëjtë dhe, së fundi, askush nuk ka qasje në atë se për kë kanë votuar qytetarët.

Kuvendi i Kosovës zgjidhet me mandat katërvjeçar, duke filluar nga dita e seancës konstituive, që mbahet brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve (neni 66.1 i **KKos**). Zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Kosovës i shpall Presidenti, i cili thërret mbledhjen e parë të tij. Në rast se ai nuk është në gjendje të thërrasë seancën e parë, Kuvendi mblidhet pa pjesëmarrjen e Presidentit. (neni 84.3 i **KKos**). Zgjedhjet e rregullta për Kuvend mbahen më së voni tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit, kurse në raste të shpërndarjes së Kuvendit, jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas shpërndarjes (neni 66.2 i **KKos**). Mandati i Kuvendit të Kosovës mund të vazhdohet vetëm në raste të gjendjes së jashtëzakonshme për masa emergjente të mbrojtjes ose në rast të rrezikut ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike të Republikës së Kosovës, dhe vetëm për aq sa zgjat gjendja e jashtëzakonshme, siç është përcaktuar me Kushtetutë (neni 66.4 i KKos). Kushtet, zonat dhe procedurat zgjedhore, rregullohen me ligj (neni 66.5 i KKos). Këtu me ligj nënkuptohet Ligji nr. 03 L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në **Re-**

[61] Cf. për trajtim të shkëlqyer dhe me burime origjinale të jetës dhe punës së Kuvendit të Kaçanikut, librin me dy vëllime të njërit prej anëtarëve të tij, dr. Skënder Skënderi, *Si veproi Kuvendi i Republikës së Kosovës*. Vëllimi I-rë (4.12.1989 – 7.09.1990) (Printing Press: Prishtinë, 2016); dhe Dr. Skender Skenderi, *Si veproi Kuvendi i Republikës së Kosovës*. Vëllimi II-të (20.07.1990-1996) (Printing Press: Prishtinë, 2016).

publikën e Kosovës, që aktualisht deri në shkrimin e këtyre rreshtave (nëntor 2022) është në fuqi me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse.

Kuvendi Kosovës ka një strukturë pak më të ndryshme se kuvendet e vendeve përeth. Ai ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre (neni 64.1 i **KKos**). Në paragrafin e dytë të nenit 64 të **KKos** përcaktohet në mënyrë të saktë shpërndarja e mandateve sipas sistemit porporcional nga paragrafi paraprak: "Në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej njëqind e njëzet (120) vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovës, si vijon:

(1) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10);

(2) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti rom një (1) vend; komuniteti ashkali një (1) vend; komuniteti egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit rom, ashkali, ose egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti boshnjak tri (3) vende, komuniteti turk dy (2) vende dhe komuniteti goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara".

Votat përllogariten në mandate përmes metodës **Sainte-Lague**. Mandatet i fitojnë listat që kanë kaluar pragun zgjedhor prej 5% nga votat e tërësishme që janë hedhur në kutitë e votimit, diçka që nuk vlen kur janë në pyetje vendet e garantuara për komunitetet e Kosovës. Nga viti 2000, nën kushte të ndryshme, komuniteteve jo shumice u janë ndarë ulëse në Kuvendin e Kosovës, nga 20 sosh në çdo Kuvend: deri në vitin 2010 kanë ekzistuar **ulëset e rezervuara**, ku subjektet politike të komuniteteve jo shumice fitonin ulëse krahas ulëseve të fituara në mënyrë të rregullt në garën zgjedhore (nëse fitonin të tilla); pas këtij viti janë anuluar **ulëset e rezervuara**, me amendamentet kushtetuese të shtatorit 2010 me të cilat u mbyll pavarësia e mbikëqyrur. Aktualisht ekziston vetëm sistemi i **ulëseve të garantuara**, i aplikuar që nga viti 2014, që nënkupton se komunitetet joshumicë garojnë kryesisht për njëzet ulëse, sipas sistemit të shumicës relative të krejt votave të vlefshme të hedhura në kuti të votimit. Me **pragun zgjedhor natyror**, që është tjetër emër për sistemin e shumicës relative që vlen për listat zgjedhore të komuniteteve të Kosovës, realizohen dispozitat kushtetuese mbi barazinë dhe përfaqësimin e komuniteteve në Kosovë. Në aspektin konceptual, një synim i njëjtë është ndjekur edhe për sa i përket barazisë gjinore: **kuotat gjinore në listat e partive** janë zbatuar për listën e kandidateve të partive politike nga viti 2000. Kjo kuotë ka qene 33%, për sa i përket 67% të kandidatëve të parë në listën e kandidatëve nga viti 2001 deri në 2004. Ndërkaq, 30%, për sa i përket numrit të përgjithshëm të kandidatëve të emëruar (apo për sa i përket 15 kandidateve të parë vetëm në vitin 2000) në rastin e zgjedhjeve të tjera. **Kuota gjinore për rezultate**, ndërkaq, është aplikuar nga viti 2001 e tutje. Për të gjitha këto dimensione kemi folur gjerësisht në seksionin 9 të pjes**ës** pararendëse të këtij libri.

Sistemi zgjedhor me një njësi të madhe zgjedhore zvogëlon legjitimitetin e përfaqësuesve të popullit dhe, për pasojë, edhe të Kuvendit të Kosovës si tërësi, për shkak se mungon lidhja e drejtpërdrejtë e kandidatit me votuesin. Ky legjitimitet, si legjitimiteti i trupit përfaqësues kosovar ashtu edhe legjitimiteti i secilit prej anëtarëve të këtij trupi, mund të shikohet edhe nga niveli i daljes në zgjedhje, që nuk ka qenë aq i lartë në pjesën dërrmuese të rasteve: mund të thuhet se mesatarja e daljes në zgjedhje është gjysma e trupës së tërësishme zgjedhore në vend.

3.2. Mandati i deputetëve

Deputetët zgjidhen për mandat katërvjeçar. Ky është mandat i rregullt dhe mund të jetë më i shkurtër dhe, teorikisht, edhe më i gjatë se katër vite.
Para nisjes së mandatit duhet të kryhet verifikimi i mandateve të fituara të deputetëve. Fillimisht, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) u lëshon nga një certifikatë secilit prej deputetëve që kanë fituar mandat dhe bën raportin përfundimtar mbi zgjedhjet e realizuara. Në seancën e parë të legjislaturës së re vërtetohen mandatet e deputetëve, si hap i parë i rëndësishëm në rrugëtimin drejt konstituimit të legjislaturës së re të Kuvendit të Kosovës. Qëllimi i seancës konstituive të Kuvendit është ndërtimi i legjislaturës së re pas zgjedhjeve me ndihmën procedurale të kryetarit të legjislaturës së mëparshme, nëse Presidenti nuk e thërret seancën e parë konstituive. Kuvendi ndërtohet nëpërmjet verifikimit dhe konfirmimit të mandatit të deputetëve, dhënies së betimit nga deputetët dhe nëpërmjet zgjedhjes së kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit. Seanca konstituive e Kuvendit nuk mund të konsiderohet së është realizuar plotësisht, nëse Kuvendi nuk ka zgjedhur kryetarin dhe nënkryetarët e tij. Vetëm kur të ndërmerren këto veprime, Kuvendi ka mundësi kushtetuese për të realizuar funksionin e vet kushtetues parësor – funksionin ligjvënës nga neni 63 i KKos. Krejt kjo procedurë normohet me kreun III të **RPKos** të vitit 2010, aktualisht në fuqi (nëntor 2020), procedurë që është elaboruar gjerësisht me një vendim të **GJKRKS** të vitit 2014, aktgjykimin KO 119/14 të datës 26 gusht 2014.[62]

Mandati deputetëve, i cili fillon ditën e certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve (neni 70.2 i KKos), **shkurtohet** me shpërndarjen e Kuvendit, i cili pas aktit të shpërbërjes kryen vetëm punët rrjedhëse dhe të pashtyeshme, kurse mandatet e deputetëve rrinë në gjendje të fjetur. Përjashtimisht, ekziston mundësia që mandatet të aktivizohen dhe Kuvendi të fitoj kapacitetin e plotë të veprimit me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, përkatësisht gjendjes së luftës dhe rrezikut për rendin kushtetues ose sigurinë publike në Kosovë në kuptim të nenit 66.4 të **KKos**. Deputetit individual, ndërkaq, i mbaron mandati më herët ose ai bëhet i pavlefshëm për arsye e shkaqe nga më të ndryshme, siç janë:

(1) ajo/ai nuk bën betimin;
(2) ajo/ai jep dorëheqjen;
(3) ajo/ai emërohet anëtar i Qeverisë së Kosovës;
(4) ajo/ai përfundon mandatin;
(5) ajo/ai mungon gjashtë (6) muaj rresht në seancat e Kuvendit. Në raste të veçanta, Kuvendi i Kosovës mund të vendos ndryshe;
(6) ajo/ai dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale me një ose më shumë vjet burgim;
(7) ajo/ai vdes (neni 70.3 i **KKos**).

Ditën e ndërprerjes së mandatit e konstaton Kuvendi në seancën e parë të radhës, me marrjen e njoftimit mbi ndërprerjen e mandatit. Vendi i ngelur zbrazët i deputetit plotësohet nga deputeti i radhës në listën zgjedhore që ka fituar mandatin. Mandatin, pra, e fiton deputeti i radhës që nuk ka fituar mandatin deri atëherë dhe që ka qenë në pritje. Nëse lista zgjedhore është koalicionale, atëherë mandati i takon sipas radhës kandidatit të parë nga i njëjti anëtar i koalicionit.

Mandati deputetit, sikundër u tha, vazhdohet nëse mbaron në kohë të gjendjes së jashtëzakonshme, që mund të ketë trajtën e luftës, kërcënimit për luftë, rrezikimit të rendit kushtetues dhe sigurisë dhe në rast të rrethanave të tjera. Në nenin 131.1 të **KKos**, kushtetutëbërësi kosovar ka përdorur shprehjen "gjendje e jashtëzakonshme" për të përshkruar tri situata specifike, të cilat janë të ngjashme me ato të përcaktuara nga nenin e saj 66.4, por pak më të specifikuara sa i përket objektit dhe subjektit të gjendjes në fjalë:

[62] Cf. më shumë për këtë në Enver Hasani & Muhamet Brahimi, *Gjyqësia kushtetuese*, fq. 805-810.

1) gjendja e jashtëzakonshme që ka nevojë për masa emergjente të mbrojtjes;
(2) gjendja e jashtëzakonshme kur ka rrezik të brendshëm ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike;
(3) gjendja e jashtëzakonshme kur ka fatkeqësi natyrore, e cila prek tërë territorin e Republikës së Kosovës ose një pjesë të tij.

Gjendja e jashtëzakonshme zgjat për aq kohë sa vazhdon të kërcënojë rreziku dhe nuk mund të zgjatë më shumë se për një periudhë prej gjashtëdhjetë (60) ditësh. Me pëlqimin e shumicës së deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë, gjendja e jashtëzakonshme, nëse është e nevojshme, mund të zgjatet për periudha pasuese prej tridhjetë (30) ditësh, por jo më shumë se për nëntëdhjetë (90) ditë shtesë gjithsej. Ky është standardi normal kushtetues për rrjedhën e gjendjes së jashtëzakonshme, e cila mund të bëhet edhe më e jashtëzakonshme se kaq dhe të zgjatet edhe për disa ditë: "Kur Presidenti konstaton se rreziku ndaj Republikës së Kosovës është i natyrës së jashtëzakonshme, Kuvendi mund të vendos që gjendja e jashtëzakonshme të zgjas më shumë se njëqind e pesëdhjetë (150) ditë, vetëm nëse për të votojnë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit" (neni 131 parag. 5 & 6 i **KKos**).

Mandatin e deputetit e karakterizojnë dy cilësi: **papajtueshmëria** (neni 72 i KKos) dhe **imuniteti** (neni i 75 **KKos**).

Në themel të **imunitetit parlamentar**, që normohet me nenin 75 të **KKos**, qëndron ndarja e pushteteve: pushteti ligjvënës mbrohet nga organi i drejtësisë (organi akuzës dhe gjyqi), kurse tërthorazi edhe nga pushteti ekzekutiv, i cili në një mënyrë merr pjesë në përzgjedhjen e kryeprokurorit të shtetit (përmes përfaqësuesve që i zgjedh Kuvendi). Deputetët hyjnë në grupin e funksionarëve që janë të veshur me imunitetin të gjerë. **Imuniteti material** nënkupton lirimin nga përgjegjësia dhe mbrojtjen e deputetit për mendimin e dhënë dhe votimin e ndërmarrë gjatë kohës së ushtrimit të funksionit të deputetit. **imuniteti nga përgjegjësia** vepron në mënyrë **automatike**, sepse deputeti nuk ka nevojë të thirret në të, dhe në mënyrë **absolute**, sepse ai vlen jo vetëm për kohën sa zgjat mandati deputetit por për tërë jetën. Ky imunitet përfshihet në fjalinë e parë të paragrafit të parë të nenit 75 të KKos, në pjesën që ndalon shkarkimin për veprimet dhe vendimet e deputetëve të ndërmarra brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si deputetë të Kuvendit. Pjesa tjetër e nenit 75 të **KKos**, në tërësi i dedikohet **imunitetit procedural** apo **paprekshmërisë**. Në paragrafin e parë përcaktohet si vijon: "Deputetët e Kuvendit gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimet dhe vendimet e tyre brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si deputetë të Kuvendit. Imuniteti nuk pengon ndjekjen penale të deputetëve të Kuvendit për veprimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive së tyre si deputetë të Kuvendit". Paragrafi i dytë më shumë shpërfaq karakterin procedural të imunitetit të paprekshmërisë, ku thuhet si vijon: "Deputeti i Kuvendit nuk mund të arrestohet dhe as ndalohet përderisa është duke kryer detyrat e tij/saj si deputet i Kuvendit, pa pëlqimin e shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit". Sado që gjuhësisht ky nen mund të duket i qartë dhe i vetëkuptueshëm, në praktikë, megjithatë, ka pasur nevojë që për të ta thotë fjalën e vet **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës** (**GJKRKS**). Për këtë arsye, e shohim të nevojshëm të përmbledhim në disa paragrafë esencën e këtij verdikti të gardianit të konstitucionalizmit kosovar. E kemi fjalën për aktgjykimin e **GJKRKS** për rastin **KO 98/11** të datës 20 shtator 2011.[63] Me këtërast, **GJKRKS** i është përgjigjur pyetjes së qeverisë lidhur me imunitetin e të gjithë funksionarëve qendrorë të Kosovës: presidentit, kryeministrit dhe ministrave të qeverisë, si dhe deputetëve të Kuvendit të Kosovës, duke elaboruar në mënyrë ekstensive të gjitha format dhe caqet e imunitetit të funksionarëve të lartë të Republikës së Kosovës. Në pikën II të aktgjykimit në këtë rast, **GJKRKS** ka theksuar qartë se, në përputhje me nenin 75.1, nenin 89 dhe nenin 98 të **KKos**, deputetët e Kuvendit të Kosovës, presidenti dhe anëtarët e qeverisë gëzojnë imunitet funksional për veprimet dhe vendimet e ndërmarra brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre përkatëse. Ata lirohen nga përgjegjësia në procedura gjyqësore të çfarëdo natyre lidhur me pikëpamjet e shprehura, mënyrën e votimit apo vendimet e

[63] *Rasti KO 98/1, Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.***Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr. ref.: AGJ138/11). Prishtinë: datë: 20 shtator 2011.

ndërmarra brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre. Ky lloj i imunitetit ka kohëzgjatje të pakufizuar. Në këtë drejtim, pra në drejtim të **imunitetit funksional**, të gjithë janë tëbarabartë dhe gëzojnë imunitet të njëjtë. Përjashtimi vlen vetëm për presidentin e republikës përsa i përket **arrestimit**, pra jo edhe llojeve tjera të imunitetit. Për dallim nga funksionarët tjerë të lartë shtetërorë, presidenti republikës gëzon **imunitet nga arrestimi** për shkak të natyrës së funksionit, i cili kërkon që ajo/ai të jetë përherë në dispozicion për të kryer detyrat e ngarkuara me **KKos** (paragrafi operativ VII.4 i Aktgjykimit).

Papajtueshmëria e funksionit të deputetit me funksionet tjera publike buron nga parimi i ndarjes së pushtetit. Nëse njëkohësisht ushtron më shumë funksione, deputeti mund të has në konflikt të interesit dhe mos të jetë në gjendje të ushtroj funksionin e deputetit në interes të votuesit, përkatësisht në interes të përgjithshëm. Papajtueshmëria mbron edhe cilësinë e ushtrimit të funksionit të deputetit sepse pengon deputetin të harxhoj kapacitetet e veta mendore e fizike në dëm të cilësisë së ligjvënies. **KKos** në mënyrë shprehimore përcakton papajtueshmërinë e funksionit të deputetit jo vetëm me funksionin në organet e pushtetit ekzekutiv, por edhe me çdo post ekzekutiv në administratën publike ose në ndonjë ndërmarrje në pronësi publike (neni 72 i KKos). Në disa kushtetuta të vendeve fqinje me Kosovën, në papajtueshmëri futet shprehimisht edhe ushtrimi i funksionit në sistem të drejtësisë. **KKos** autorizon ligjvënësin që më tutje të qartësojë me saktësi se cilat janë zonat e **konfliktit të interesit** të përshkruara në nenin 75 si më sipër.

Përveç dispozitës së sipërcekur mbi papajtueshmërinë e përgjithshme, **KKos** në dispozitën e parë të nenit 73 flet edhe për **pamundësinë e kandidimit për deputet** të kategorive të caktuara të individëve, posteve dhe përgjegjësive. Në paragrafin e parë të këtij neni jepet lista shteruese e personave që nuk mund të kandidohen dhe as të zgjidhen deputetë të Kuvendit, pa hequr dorë paraprakisht nga detyra e tyre. Ata janë: (1) gjyqtarët dhe prokurorët; (2) pjesëtarët e Forcës së Sigurisë të Kosovës; (3) pjesëtarët e Policisë së Kosovës; (4) pjesëtarët e Doganave të Kosovës; (5) pjesëtarët e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë; (6) udhëheqësit e agjencive të pavarura; (7) përfaqësuesit diplomatikë; (8) kryetarët dhe anëtarët e **KQZ-së**. Sikundër shihet, nga këta persona kërkohet që të heqin dorë paraprakisht nga detyra e tyre nëse duan të kandidohen dhe të marrin postin e deputetit të Kosovës. Dispozita e dytë e të njëjtit nen të **KKos** flet për personat që kanë kufizim absolut për të kandiduar për deputet, deri sa të zgjatë një gjendje në të cilën ata gjenden: nuk mund të kandidohen për deputetë personat e privuar nga zotësia juridike për të vepruar, me vendim përfundimtar të gjykatës, thuhet në këtë dispozitë kushtetuese. Në paragrafin e fundit, të tretë, të këtij neni normohet pamundësia e kandidimit të individëve që mbajnë përgjegjësi ekzekutive në nivel komune: kryetarët dhe zyrtarët e tjerë, të cilët mbajnë përgjegjësi ekzekutive në nivel komune, nuk mund të zgjidhen si deputetë të Kuvendit pa hequr dorë paraprakisht nga detyra e tyre. Pra edhe këtu kërkohet heqja dorë paraprakisht nga detyra e tyre para se të kandidohen, të cilën duhet ta deponojnë në **KQZ**.

Sa i përket **natyrës juridike** të mandatit të deputetit, **KKos** e bën të qartë se mandati nuk është mandat i detyrueshëm (imperativ), por **mandat i lirë**. Kështu është edhe në vendet fqinje me Kosovën dhe i tillë ka qenë edhe në të kaluarën pas përqafimit të demokracisë kushtetuese në këto vende, me përjashtim të Serbisë, e cila, deri në vitin 2011 ka kultivuar mandatin imperativ dhe "dorëheqjet blanko" (deputeti nënshkruan një deklaratë se nëse ndërron partinë, do të dorëhiqet nga posti i deputetit në mënyrë automatike). Deputetët e Kuvendit janë përfaqësues të popullit dhe nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues, thuhet në paragrafin e parë të nenit 75 të **KKos**. Kjo nënkupton se **mandati lirë** paraqet garancion kushtetues dhe nuk normohet me ligj sektorial që rregullon punën e parlamentit, siç bëjnë disa vende përreth Kosovës. Kuadri juridik për ushtrimin e funksionit të deputetit përcaktohet me nenin 74 të KKos, në një dispozitë të vetme, që thotë: "Deputetët e Kuvendit të Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit".

Natyra juridike e mandatit të lirë, si një kategori juridiko-kushtetuese sipas së cilës deputeti përfaqëson të gjithë qytetarët, me shumë vështirësi pajtohet me diskriminimin pozitiv të komuniteteve pakicë në Kosovë. Kjo për shkak se deputetët e zgjedhur nga listat zgjedhore të komuniteteve pakicë në Kosovë përfaqësojnë pjesëtarët dhe vetë komunitetin të cilit i takojnë, ose janë deklaruar se i takojnë me rastin e kandidimit për deputetë të Kuvendit të Kosovës. Kjo është arsyeja se për ta vejnë kushte më të buta dhe nuk i nënshtrohen rregullave mbi pragun zgjedhor të përcaktuar me ligj, siç kemi shpjeguar më sipër. Për këtë arsye edhe shpjegimet tona mbi mandatin e lirë si më sipër nuk vlejnë në tërësi kur bëhet fjalë për mandatet e komuniteteve pakicë në Kosovë. Kjo është thelbi i variantit të demokracisë kushtetuese në Kosovë, i njohur si **demokraci konsociacionale**, që gjen shprehjen e vet që nga momenti i definimit të origjinës së pushtetit, organizimit dhe funksionimit të tij e deri te roli i spikatur i individit në shoqëri.[64] Në fakt, **demokracia konsociacionale** në Kosovë u instalua menjëherë pas mbarimit të luftës, në qershor të vitit 1999, përmes rregullativës së administratës ndërkombëtare në Kosovë, përkatësisht rregullativës së **UNMIK**. Nëse analizohen dispozitat e **KKos** mbi liritë e të drejtat e njeriut dhe të komuniteteve (kapitujt dy dhe tre), do të shihet qartë se ato nuk kanë ndonjë dallim thelbësor me dispozitat që ka instaluar **UNMIK-u** për lëmin e njëjtë: në dy rastet bëhet fjalë për futjen në mënyrë të sforcuar të disa garancive juridike në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve, me qëllim të promovimit dhe ruajtjes së **demokracisë konsociacionale**. Kjo është bërë pas konfliktit të përgjakshëm në Kosovë, të shkaktuar nga forcat serbe (1998-1999), dhe përçarjes së thellë që ka ndodhur në shoqërinë kosovare përgjatë vijave etnike, fetare, gjuhësore, kulturore dhe në çdo aspekt tjetër mes popullsisë shqiptare të Kosovës, si shumicë, dhe serbëve si sundues të dikurshëm të Kosovës.

Arsyet për instalim të **demokracisë konsociacionale**, kryesisht janë të natyrës historike, gjë që është vërejtur në literaturën themeluese mbi këtë lloj të demokracisë kushtetuese dhe funksionit që luan. Ndarjet e thella dhe fragmentimet e brendshme nëpër nënkultura armiqësore, e thotë ideatori i këtij koncepti, **Arend Liphart** (Arend Lijphart: 1909-1963), mund të adresohen vetëm përmes instalimit të **demokracisë konsociacionale**.[65] Kjo demokraci, pra, instalohet si një "përpjekje e vetëdijshme e elitës me qëllim të stabilizimit të sistemit".[66] Instalimi nga "lart-poshtë" i **demokracisë konsociacionale** me qëllim të stabilizimit të sistemit bëhet si një përpjekje e qëllimshme e elitës, e bërë me synim konsolidimin e strukturave dhe formacioneve të përcaktuara kushtetuese, në veçanti kundrejt faktorit të jashtëm.[67] Ky model i demokracisë nënkupton futjen e garancioneve dhe mekanizmave specifikë kushtetues për promovimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të komuniteteve etnike dhe komuniteteve të tjera joshumicë. Me këtë hap në **pushtetndarjen e gjithanshme**, bëhet e qartë se modeli konsociacional i ndarjes së pushtetit në planin horizontal dhe vertikal, si dhe njohja e vetos për komunitetet lidhur me çështjet që prekin interesat e tyre vitale, me qëllim të sigurimit të garancioneve të pranuara kushtetuese paraqet një projekt real dhe serioz në funksion të ndërtimit të shoqërisë së re dhe stabilizimit të saj konform parimeve liberale të demokracive kushtetuese perëndimore, pra jo duke u bazuar në strukturat shoqërore materiale ekzistuese apo historisë së kaluar të vendit.

---

64 Për shtjellimet e para të kësaj demokracie në kontekstin kosovar, Dren Doli dhe Fisnik Korenica, "The Consociational System of Democracy in Kosovo: Questioning Ethnic Minorities' Special Status in Kosovo's Constitutional Regime ", *International Journal of Public Administration* Vol. 36 No. 9 (2013), fq. 601–613. Cf. edhe publikimin e mëvonshëm të Adem Behës, "Consociational Democracy and Political Engineering in Postwar Kosovo". *Nationalities Papers* Vol. 47 Issue 4 (July 2019), fq. 674-689.

65 Arend Lijphart, "Consociational Democracy", W*orld Politics* Vol. 11 No. 2 (1969), fq. 207-225, në fq. 213, 215.

66 Arend Lijphart, "Constitutional Design for Divided Societies" *Journal of Democracy* Vol. 15 No. 2 (2004), fq. 96-109, në fq. 97.

67 Louis Aucoin, "Views from the Field On Constitution Writing: The Case of Kosovo (Interview)". *PRAXIS: The Fletcher Journal of Human Security* XXIII, (2008): fq. 123-128, në fq. 125; John Tunheim, "Rule of Law and the Kosovo Constitution". *Minnesota Journal of International Law* 18, no. 2 (2009): fq. 371-379 në fq. 375; Cf. Emily Hay, "International (ized) Constitutions and Peacebuilding". *Leiden Journal of International Law* 27, no. 01, (2014): fq. 141 – 168, në fq. 160-161 (duke folur për rastin e Kosovës; e njëjta vlen edhe për **Libanin**, **Qipron** dhe **Bosnjë-Hercegovinën**, si raste tipike ku është provuar demokracia konsociacionale).

Modeli i demokracisë kushtetuese që cilësohet si **demokraci konsociacionale**, si një praktikë ku ekziston një ndërprerje radikale me strukturat shoqërore materiale të së kaluarës dhe të tashmes, më së miri shihet në rastin e **Kosovës** dhe **Bosnjë-Hercegovinës**, si dy shtete që kanë kushtetuta të reja, demokratike dhe moderne, që synojnë të prodhojnë dhe ndërtojnë identitete tërësisht të ndryshme nga identitetet e kaluara dhe nga identitetet ekzistuese etnike, fetare, gjuhësore, si dhe nga përbërësit e tjerë të strukturave materiale shoqërore të këtyre dy vendeve. Në **Evropë** dhe gjetiu, ndërkaq, si tregime suksesi që vlen të përmenden janë **Belgjika** dhe **Libani**, kurse **Qipro** si një tregim gjysmë suksesi. Vlen të theksohet këtu se vendet përreth **Kosovës** nuk kultivojnë këtë lloj të demokracisë, me përjashtim të **Maqedonisë Veriore**, e cila, kur bëhet fjalë për të a.q. **Parimi i Badinter**, ngjason me demokracinë konsociacionale.

Futja e këtij modeli të demokracisë në Kosovë ka qenë pasojë e drejtpërdrejtë e ndikimit të fuqishëm të faktorit ndërkombëtar në draftimin e **Deklaratës së Pavarësisë** dhe **KKos**.[68] Pjesëmarrja e vendeve të huaja dhe faktorit tjetër ndërkombëtar në ndërtimin dhe ushtrimin e **pushtetit origjinal kushtetutëbër**ës (**pouvoir constituiant originaire**), jo domosdo është gjë e keqe: rastet e **Gjermanisë** dhe **Japonisë** pas Luftës së Dytë Botërore janë shembull tipik i anëve pozitive të situatave kur pushteti origjinal kushtetutëbërës ndahet me vendet e huaja dhe faktorët tjerë ndërkombëtarë. Kjo nënkupton që arsyet për instalim të **demokracisë konsociacionale** në Kosovë janë të natyrës historike: me shumë të drejtë është vërejtur para shpalljes së pavarësisë se, e kaluara tragjike në Kosovë, "ndarjet e thella dhe fragmentimet e brendshme nëpër nënkultura armiqësore",[69] kanë mundur të adresohen vetëm përmes instalimit të demokracisë konsociacionale. Kjo demokraci, pra, është instaluar si një "përpjekje e vetëdijshme e elitës me qëllim të stabilizimit të sistemit".[70] Instalimi nga "lart-poshtë" i demokracisë konsociacionale me qëllim të stabilizimit të sistemit, në rastin kosovar përkthehet si një përpjekje e qëllimshme e elitës vendore, e bërë me synim konsolidimin e shtetësisë në planin ndërkombëtar dhe fitimin e sa më shumë njohjeve ndërkombëtare.[71] Ky model i demokracisë nënkupton futjen e garancioneve specifike kushtetuese për promovimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të komuniteteve etnike dhe të komuniteteve tjera kosovare: me këtë hap në pushtetndarjen e gjithanshme, Kosova ia ka bërë të qartë botës se modeli konsociacional i ndarjes së pushtetit në planin horizontal dhe vertikal, si dhe njohja e vetos për komunitetet lidhur çështjet që prekin interesat e tyre vitale, paraqet një projekt real dhe serioz në funksion të ndërtimit të shtetit kosovar sipas parimeve liberale të demokracive kushtetuese perëndimore.

Me **KKos** qartë përcaktohet modeli **konsociacional i demokracisë**. Ky model përshkon dhe reflektohet në **Deklaratën e Pavarësisë**, në preambulën e **KKos** dhe në çdo normë të saj: preambula e cilëson Kosovën si një shtet të të gjithë qytetarëve të barabartë, kurse dispozitat kushtetuese fuqizojnë komunitetet pakicë. Si rezultat i instalimit të demokracisë konsociacionale, në Kosovë ekziston një kapitull shtesë mbi liritë dhe të drejtat e komuniteteve (kapitulli i tretë i KKos., nenet 57-62). Krejt natyrshëm, kjo pjesë pasohet me kapitujt që normojnë organizimin e pushtetit dhe mënyrën e ushtrimit të tij. Këtu

68 Në literaturë kjo është cilësuar si ndarje e **pushtetit origjinal kushtetutëbërës** në mes të vendorëve dhe ndërkombëtarëve. Cf. më shumë për këtë në Cf. Emily Hay, "International (ized) Constitutions and Peacebuilding". *Leiden Journal of International Law* Vol. 27, No. 1 (2014), fq. 141-168 (autori, duke analizuar nga aspekti komparativ rastet e Kosovës dhe të Irakut, vjen në përfundimin se kushtetutat e ndërkombëtarizuara gjatë historisë kanë potencial për të qenë legjitime dhe jolegjitime, në varësi të rrethanave të secilit vend dhe kontekstit historik; autori në mënyrë të shkëlqyer konstaton, duke sqaruar pse-në, se kushtetutat e ndërkombëtarizuara sfidojnë rëndë konceptet themelore tradicionale mbi sovranitetin, vetëvendosjen, kushtetutën dhe rolin e funksionin e saj në një shoqëri të organizuar në shtet).

69 Arend Lijphart, "Consociational Democracy", fq. 213, 215.

70 Arend Lijphart, "Constitutional Design for Divided Societies", fq. 97.

71 Dren Doli dhe Fisnik Korenica "The Consociational System of Democracy in Kosovo: Questioning Ethnic Minorities' Special Status in Kosovo's Constitutional Regime", fq. 602; Fisnik Korenica & Dren Doli, "The Politics of Constitutional Design in Divided Societies: The Case of Kosovo" *Croatian Yearbook of European Law and Policy* 6, no. 6 (2010): fq. 265-292 në fq. 273-274; Professor Louis Aucoin, "Views from the Field On Constitution Writing: The Case of Kosovo (Interview)". *PRAXIS: The Fletcher Journal of Human Security* XXIII, (2008): fq. 123-128, në fq. 125; John Tunheim, "Rule of Law and the Kosovo Constitution" *Minnesota Journal of International Law* 18, no. 2 (2009): fq. 371-379 në fq. 375; Cf. Emily Hay, "International (ized) Constitutions and Peacebuilding", fq. 160-161.

vijnë në shprehje në rend të parë dispozitat mbi organizimin e pushtetit në nivel qendror: Kuvendi (kapitulli katërt, nenet 63-82 të KKos), Presidenti i Kosovës (kapitulli i pestë, nenet 83-91 të KKos), Qeveria (kapitulli i gjashtë, nenet 92-101 të KKos), Sistemi Drejtësisë (nenet 102- 111 të KKos) dhe Gjykata Kushtetuese (kapitulli tetë, nenet 112-118 të KKos). Të gjitha këto dispozita reflektohen në liri dhe të drejta për komunitetet, në veçanti në të drejtën e tyre për të marrë pjesë në jetën politike dhe institucionale të vendit. Asnjë organ i shtetit në nivel qendror dhe në nivel lokal nuk guxon të mosreflektoj përbërjen multietnike të vendit. Në aspektin politik ndërkaq, dispozitat kushtetuese si më sipër prodhojnë këtë rezultat:

- e para, koalicionet e mëdha në nivel qendror (përbërja e ekzekutivit duhet domosdo të reflektoj këtë kërkesë kushtetuese);
- e dyta, autonominë kulturore segmentare në nivel qendror dhe një vetëqeverisje të thellë lokale;
- e treta, proporcionalitetin në përfaqësim pa marrë parasysh fuqinë zgjedhore (kjo reflektohet si në përbërjen e Kuvendit, ku nuk ekziston pragu zgjedhor për komunitetet pakicë, ashtu edhe në përbërjet e kuvendeve komunale); dhe
- e katërta, të drejtën e vetos së pakicave në çështjet që prekin interesat e tyre vitale (legjislacioni me interes vital në sferat e numëruara në nenin 81 të KKos, nuk mund të miratohet pa votën e shumicës absolute të komuniteteve pakicë në Kuvendin e Kosovës; këto sfera kanë të bëjnë me legjislacionin mbi kufijtë komunalë, përdorimin e gjuhëve, zgjedhjet lokale, liritë fetare, arsimin në të gjitha nivelet dhe, në fund, simbolet e komuniteteve dhe festat publike).

Me qëllim të ofrimit të një sigurie në zbatim të këtyre premisave të demokracisë konsociacionale në Kosovë, gardiani i **KKos** ka juridiksion të posaçëm sa i përket amendamenteve kushtetuese: neni i saj 113.4 ofron një siguri shtesë, sepse autorizon Gjykatën Kushtetuese për vlerësim kushtetues të pajtueshmërisë së amendamenteve të propozuara kushtetuese me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare. Ky autorizim shtrihet në rend të parë ndaj tetë marrëveshjeve të instrumenteve ndërkombëtare të numëruara në nenin 22 të Kushtetutës dhe ngërthen detyrimin e interpretimit të garancive mbi të drejtat e njeriut nga kapitulli dy dhe tre i KKos në pajtim më vendimet e **GJEDNJ-së** (neni 53 i Kushtetutës së Kosovës).[72]

Në frymën e këtij tregimi mbi natyrën e **demokracisë konsociacionale** në Kosovë ka qenë edhe një prononcim i **Gjykatës Supreme të Kosovës** (GJSKos) në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021, kur një grup kandidatësh që pretendonin se përfaqësojnë komunitetin boshnjak, me ndihmën e subjektit më të madh politik serb në Kosovë, arriti të deformoj vullnetin e komunitetit boshnjak: votat që mori ky komunitet nuk ishin nga vendbanimet me votues boshnjakë, por me votues serbë përmbi 90%. Rasti ka pasur të bëj me interpretimin e nenit 15 të **Ligjit nr.03/L-073** për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës (2008), i cili ka operacionalizuar nenin 64.2 të **KKos**.

Paragrafi 11 i nenit 15 të **Ligjit nr.03/L-073** përcakton si vijon: "Çdo subjekt politik në kërkesën e tij tregon nëse dëshiron të hyjë në garë për të fituar ndonjërin prej vendeve të garantuara për përfaqësim të serbëve dhe komuniteteve tjera joshumicë të Kosovës, sipas nenit 64 të Kushtetutës". Ky kusht formal, fare lehtë mund të testohet ne praktikë, siç ka dëshmuar GJSKos në arsyetimin e vet të aktgjykimit për rastin që po diskutohet këtu.[73] Në vijim të konstatimit, nëse janë plotësuar këto kushte formale të kësaj dispozite ligjore, **GJSKos** ka konstatuar me të drejtë se "[...] deklarimi i personit si kandidat për përfaqësues të një komuniteti nuk është i mjaftueshëm për t'u certifikuar si kandidat për vendet e rezervuara për atë komunitet, sepse nëse kandidati nuk ka një lidhje objektive me komunitetin në kuptimin e përkatësisë etnike, nuk do t'i plotësojë konditat e përfaqësuesit për komunitetin e dhënë për vendet e rezervuara". Ky kusht formal në praktikë mund të testohet fare lehtë, përkatësisht përkatësia një komu-

[72] Silvia Suteu, *Eternity Clauses in Democratic Constitutionalism* (Oxford University Press: Oxford, 2021), fq. 65-66.
[73] Gjykata Supreme e Kosovës. Aktgjykim. AA.nr.30/2021. Datë 11 mars 2021 (Prishtinë).

niteti joshumicë kosovar, në bazë të kritereve të tjera objektive: siç janë vendbanimi i gjatë në një vend, gjuha, religjioni, krahas deklarimit subjektiv të një personi që regjistrohet në regjistrat përkatës civilë. Kjo është korrekte edhe në aspektin kushtetues, sepse vetë neni 57.1 i **KKos** përdor kritere objektive për definim të komuniteteve të Kosovës.[74]

Konstatimin e vet si më sipër, përkatësisht që nuk mjafton vetëm deklarimi formal i një subjekti se përfaqëson komunitetin përkatës kosovar, **GJSKos** e ka prodhuar pasi ka vërejtur se, në bazë të shkresave të lëndës, "[...] është paraqitur fenomeni i votimit në mënyrë masive nga votuesit e një komuniteti për kandidatet e certifikuar të një subjekti politik për vendet e rezervuara të komunitetit tjetër dhe në këtë mënyrë është pamundësuar përfaqësimi i komunitetit boshnjak nga përfaqësues të cilët dalin fitues të vendeve të rezervuara për komunitetin në fjalë, sipas vullnetit të votuesve të atij komuniteti". Kjo mënyrë votimi është joligjore, ka thënë GJSKos, pikërisht duk u mbështetur në postulatet e **demokracisë konsociacionale** të garantuar nga **KKos**., "[...] që nënkupton ndarjen e pushtetit midis grupeve të ndryshme të shoqërisë në një vend të caktuar. Sipas këtij koncepti sendërtohen mekanizmat e qëndrueshmërisë politike në një shoqëri më ndarje sipas grupeve të ndryshme veçanërisht etnike, pa përjashtuar ato gjuhësore, fetare etj". Në **KKos**, thuhet më tej në arsyetimin e **GJSKos**, "[...] përmes vendeve të rezervuara për komunitet joshumicë është synuar përfaqësimi i të gjitha grupeve në organin përfaqësues, andaj për këtë përfaqësim duhet të ekzistoj lidhje objektive në mes të përfaqësuesve dhe votuesve të komunitetit përkatës, përndryshe deformohet përfaqësimi efektiv i komuniteteve për të cilat Kushtetuta ka garantuar vendet e rezervuara, e për të cilat vende nuk ekziston sa i përket subjekteve të certifikuara pragu zgjedhor".[75]

3.3. Kompetencat

Kompetencat e Kuvendit të Kosovës burojnë nga fizionomia kushtetuese e këtij organi kushtetues, e përcaktuar jo vetëm me nenin 63 të **KKos** por edhe me dispozitat tjera të aktit më të lartë juridik në **Kosovë**. Në fakt, ky nen e definon Kuvendin vetëm si organ ligjvënës, jo edhe si organ kushtetues i veshur me pushtet konstituiv – pushtet për bërje të kushtetutës së re ose amendamentim të kushtetutës aktualisht në fuqi. Në një mënyrë shumë paradoksale, neni 63 i **KKos** flet në shumës për parimet e përgjithshme lidhur me **Kuvendin e Kosovës**, përkundër që nuk jep asnjë parim që do të mund të shërbente si një udhërrëfyes për lexuesin dhe publikun e gjerë për njohjen e fizionomisë së këtij organi kushtetues. Në këtë nen, dy cilësi të Kuvendit shpërfaqen në mënyrë të qartë: e para, cilësia e tij si organ ligjvënës; dhe, e dyta, cilësia e të qenurit organ që zgjidhet drejtpërdrejtë nga populli. Cilësia e organit kushtetutëbërës përcaktohet në brendi të dispozitave operative të KKos, përkatësisht në dispozitat e neneve 65 (2) lidhur me nenin 144 (3). Mbi këtë bazë mund të thuhet se ai është njëkohësisht organi më i lartë përfaqësues në vend dhe shprehje e sovranitetit të qytetarëve.

Krejt punët që kryen Kuvendi, që përbëjnë tërësinë e kompetencave të tij kushtetuese, mund t'i ndajmë në tri grupe:

- **normative;**
- **zgjedhore;** dhe
- **kontrolluese.**

Në kuadër të **kompetencave normative**, Kuvendi miraton aktet më të rëndësishme në shtet. Ai ka pushtet kushtetutëbërës – miraton KKos dhe amendamentet në të. Për dallim nga disa vende fqinje që krahas Kuvendit i japin zë edhe vullnetit të qytetarëve për miratim të kushtetutës së re, apo edhe amen-

[74] Neni 57.1 i **KKos** përcakton: "Banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës (Komunitetet), gëzojnë të drejta të veçanta, të përcaktuara me këtë Kushtetutë, krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të përcaktuara në Kapitullin II të kësaj Kushtetute.

[75] Cf. faqet 9-11 të aktgjykimit të **GJSKos** (fusnota 73 **supra**).

damenteve të natyrës së caktuar, në Kosovë kjo prerogativë nuk ndahet me askënd dhe i takon vetëm Kuvendit.

Ligjet janë aktet themelore të përgjithshme që i miraton Kuvendi, për çka edhe cilësohet si organ ligjvënës në nenin 63 të KKos, përkatësisht si bartës i pushtetit ligjvënës. Kuvendi miraton edhe akte të tjera: vendime, rezoluta, rekomandime, rregullat e procedurës së vet dhe akte të tjera të përgjithshme. Dokumenti më i rëndësishëm ndër to është **Rregullorja e Punës** (RrP), që normohet më një nen të vetëm, nenin 76 të **KKos**, dhe që miratohet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Në Kosovë nuk ekziston kompetenca e interpretimit autentik të akteve të miratuara nga Kuvendi, siç ka qenë dikur dhe siç ekziston akoma si kompetencë në disa vende përreth **Kosovës**.

Deklaratat dhe rezolutat janë akte kryesisht me natyrë politike, me të cilat shprehet një qëndrim i parlamentit mbi një çështje ose bëhet publike politika lidhur me ndonjë çështje politike ose shtetërore. Formën e ligjeve e kanë edhe disa akte të Kuvendit, siç janë aktet me të cilat ratifikohen marrëveshjet ndërkombëtare, rregullohet planifikimi hapësinor e zhvillimor dhe, së fundi, miratohet buxheti. **RP** miratohet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Dispozitat e saj përcaktojnë organizimin e brendshëm dhe mënyrën e punës së Kuvendit.

Kompetencat zgjedhore përfshijnë zgjedhjen, bashkëpunimin, kontrollin dhe largimin e organeve të tjera të pushtetit. Të drejtat zgjedhore të Kuvendit nisin me zgjedhjen e qeverisë, bartësin e pushtetit ekzekutiv në Kosovë, të cilën e zgjedh dhe vendos për ndërprerjen e parakohshme të mandatit të saj, me shumicën e votave të të gjithëve deputetëve të saj (neni 65.8 lidhur me nenin 100.4 të **KKos**). Në kompetencat tjera zgjedhore të Kuvendit hyjnë:

- zgjedhja dhe shkarkimi i kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit (neni 65.6 i KKos);
- zgjedhja dhe mundësia për shkarkim të Presidentit të Republikës së Kosovës (neni 65.7 i KKos);
- zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës (neni 65.10 i KKos); dhe, së fundi,
- propozimi gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (neni 65.11 i KKos).

Në fund, **kompetencat e kontrollit**, Kuvendi i ushtron në raport me qeverinë, si kompetenca më e rëndësishme e kuvendit: me qëllim të kontrollit parlamentar të qeverisë, kuvendi ka në disponim **pyetjet parlamentare**, **interpelancën**, **votimin e mosbesimit** ndaj qeverisë, formimi i **komisioneve hetimore**, paraqitjet e **raporteve** mbi punën e organeve të ndryshme që varen prej tij. Kuvendi mbikëqyr politikën e jashtme, të sigurisë dhe politikën e mbrojtjes. Kuvendi gjithashtu ushtron kontroll, përmes raportimeve, edhe ndaj punës së organeve të tjera që i zgjedh vetë.

Kompetencat e rëndësishme kuvendi i ushtron si trup në të cilin është bartur sovraniteti popullor: vendos për luftën dhe paqen për shkak se jep pëlqimin për dekretin e presidentit mbi shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme (neni 65.13 i KKos). Kjo do të thotë se pëlqimi i kuvendit ka karakter konstituiv. Se kjo është kështu, shihet nga fakti se, në **Kosovë** nuk ekziston stipulimi kushtetues që autorizon **Presidentin e Republikës së Kosovës**, kryeministrin dhe kryetarin e Kuvendit për të marr vendim për luftën dhe paqen, nëse Kuvendi nuk mund të mblidhet. Një mundësi e tillë ekziston në kushtetutat e disa prej vendeve fqinje me Kosovën, diçka që përjashtohet nga formulimi i dispozitave të nenit 131 të **KKos**, e cila, deri në fund, autorizon vetëm Kuvendin për të vendosur lidhur rrethanat e gjendjes së jashtëzakonshme, në të gjitha trajtat e saj, brenda afateve të përcaktuara në mënyrë rigoroze. Këto afate ndryshojnë. Kur bëhet fjalë për masat emergjente, Kuvendi duhet të jap pëlqimin brenda afatit prej dyzetë e tetë (48) orëve, me dy të tretat e votave. Nëse nuk jepet pëlqimi, dekreti i presidentit të republikës për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme nuk ka forcë as efekt (neni 131.4 i **KKos**). Nëse ka rrezik ndaj rendit kushtetues dhe sigurisë publike në Republikën e Kosovës, ose ekziston një fatkeqësi natyrore në tërë territorin e Republikës së Kosovës ose një pjesë të tij, pëlqimi i Kuvendit jepet brenda 48 orësh, por me votat e shumicës absolute

të deputetëve. Edhe këtu, mungesa e pëlqimit të dhënë nga Kuvendi i bën pa efekt dhe forcë përpjekjet e presidentit të republikës (neni 131.5 i **KKos**). Një shumicë absolute kërkohet për vazhdimin e gjendjes së jashtëzakonshme përtej gjashtëdhjetë (60) ditëve fillestare (neni 131.6 i **KKos**). Ky vazhdim mund të jetë, me këtë shumicë absolute, edhe për nëntëdhjetë (90) ditë të tjera. Me shumicën e dy të tretave (2/3), Kuvendi mund të vendos që gjendja e jashtëzakonshme të zgjas më shumë se njëqind e pesëdhjetë (150) ditë. Me kaq mbyllet çdo gjë. Teknikisht, siç shihet, asnjë veprim i ekzekutivit dhe shefit të shtetit në kohën e gjendjes së jashtëzakonshme nuk mund të ndërmerret pa bekimin e **Kuvendit të Kosovës**.

Ky rol i Kuvendit, për çudi, mungon kur bëhet fjalë për **territorin e shtetit**, si një element qenësor material përbërës i shtetit si subjekt i së drejtës ndërkombëtare: në menynë e kompetencave të Kuvendit në nenin 65 të **KKos** nuk ka asnjë fjalë për autorizimin e përfaqësuesit të sovranit për të vendosur për ndryshim të kufijve dhe tjetërsim eventual të ndonjë pjese të territorit të Kosovës. Kësi dispozita përmbajnë jo vetëm shumica e vendeve fqinje me **Kosovën**, por edhe gjetiu në Evropë dhe nëpër botë (sic!). neni 2.2 i **KKos**, që mban titullin "Sovraniteti", konstaton se sovraniteti dhe integriteti territorial i **Republikës së Kosovës** është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm dhe mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me **KKos** dhe me ligj. Me formulime të ndryshme, kjo dispozitë gjendet edhe në kushtetutat e vendeve të tjera që autorizojnë parlamentet e tyre për të vendosur lidhur me kufijtë dhe integritetin territorial të vendit. Dispozita e nenit 2.2 të **KKos**, ndërkaq, ka karakter thjeshtë deklarativ dhe të parimit të përgjithshëm kushtetues në sferën e mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit dhe nuk mund të përkthehet në një autorizim në favor të Kuvendit për vendosje lidhur me kufijtë shtetërorë.

3.4. Organizimi i brendshëm

Kuvendi i Kosovës është **parlament njëdhomësh**, strukturën e brendshme të të cilit e përbëjnë: kryetari, nënkryetarët, kryesia, trupat punues (që quhen komisione) dhe grupet parlamentare.

Kuvendi i Kosovës nga radhët e veta zgjedh Kryetarin dhe pesë (5) nënkryetarë (neni 67.1 i **KKos**). Kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar dhe zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit (neni 67.2 i **KKos**). Tre (3) nënkryetarët të propozuar nga tri grupet më të mëdha parlamentare, zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit (neni 67.3 i **KKos**). Dy (2) nënkryetarë përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kuvend dhe ata zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve. Njëri nënkryetar do të jetë nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vendet të rezervuara ose të garantuara të komunitetit serb dhe tjetri nënkryetar nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara nga komunitetet tjera që nuk janë shumicë (neni 67.4 i **KKos**). Kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit shkarkohen me votën e shumicës prej dy të tretave (2/3) të numrit të përgjithshëm të deputetëve (neni 67.5 i **KKos**). Kryetari dhe nënkryetarët formojnë Kryesinë e Kuvendit. Kryesia është përgjegjëse për funksionimin administrativ të Kuvendit në mënyrën e përcaktuar me Rregulloren e Punës të Kuvendit (neni 67.6 i **KKos**). Për dallim nga vendet fqinje ku posedon disa kompetenca substanciale, siç janë shpallja e zgjedhjeve për shefin e shtetit, kryetari Kuvendit në Kosovë nuk ka asnjë kompetencë të natyrës së tillë. Kompetencat e tij në Kosovë janë më shumë administrative-formale dhe ceremoniale, të përcaktuara me nenin 67.7 të **KKos**. Në këtë nen thuhet se kryetari i Kuvendit ushtron detyrat për sa vijon:

- përfaqësimi i Kuvendit;
- përcaktimi i rendit të ditës, thirrja dhe kryesimi seancave;
- nënshkrimi akteve të miratuara nga Kuvendi; dhe
- ushtrimi edhe i funksioneve të tjera, në bazë të **KKos** dhe **RP**.

Sekretari është udhëheqës i administratës së Kuvendit, në vartësi të Kryesisë (neni 80.3 i RP). Administrata e Kuvendit ofron mbështetje profesionale, administrative dhe teknike për nevoja të Kuvendit, të

Kryesisë, të komisioneve, të grupeve parlamentare dhe të deputetëve të Kuvendit (neni 80.1 i RP). **Komisionet** janë trupa të rëndësishëm të Kuvendit, që shqyrtojnë propozimet e ligjeve, mbikëqyrin politikën dhe punën e resorëve të ekzekutivit, parashtrojnë iniciativa. Ato mund të zbusin ose zgjidhin mosmarrëveshjet mes pushtetit dhe opozitës lidhur me propozimin e ndonjë dispozite, sepse puna e tyre nuk i nënshtrohet presionit të publikut, siç ndodh me punën e seancës plenare të Kuvendit.

Kuvendi i Kosovës emëron **komisione të përhershme**, **komisione funksionale** dhe **komisione *ad hoc***, që pasqyrojnë përbërjen politike të Kuvendit (neni 77.1 i **KKos**). Me kërkesën e një të tretës (1/3) së të gjithë deputetëve të tij, Kuvendi cakton komisione për një çështje të veçantë, duke përfshirë edhe çështje hetimore (neni 77.2 i **KKos**). Së paku një zëvendëskryesues i secilit komision parlamentar, do të jetë nga radhët e komunitetit tjetër nga ai i kryesuesit (neni 77.3 i **KKos**). Kompetencat dhe procedurat e komisioneve përkufizohen me Rregulloren e Punës të Kuvendit (neni 77.4 i **KKos**). Kuvendi e përcakton numrin e komisioneve të përhershme dhe funksionale. Kryesia e propozon numrin e anëtarëve për çdo komision. Deputeti i Kuvendit, në parim, mund të jetë anëtar vetëm në një komision (neni 69.6 i **RP**).

Aktualisht, **komisione të përhershme** janë: Komisioni për Buxhet dhe Financa, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, dhe Komisioni për Integrime Evropiane (neni 69.3 i **RP**).

Sa i përket **komisioneve funksionale**, ndërkaq, aktualisht janë si vijon: Komisioni për Punë të Jashtme, Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sporte, Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Komisioni për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Komisioni për Mandat, Imunitet dhe Rregullore të Kuvendit (neni 69.4 i **RP**). Çdo komision, për detyra specifike, me anëtarët e vet mund të formojë **nënkomisione**. Për formimin e nënkomisionit dhe për listën e anëtarëve të tij, duhet të njoftohet Kryesia e Kuvendit (neni 70.1 i **RP**).

Komisionet **ad hoc** janë komisione që e kanë autoritetin e komisioneve funksionale. Komisioni **ad hoc** është komision i përkohshëm, i cili merret me shqyrtimin e një çështjeje të veçantë. Nëse Kuvendi e formon një komision **ad hoc**, në vendimin e formimit duhet të përfshihet përbërja e komisionit (neni 71.1 i RP). Me akte të veçanta të procedurës, që miratohen nga Kuvendi me shumicën e dy të tretave (2/3) të votave të deputetëve të pranishëm, rregullohen **hetimet parlamentare** (neni 71.3 i RP). Komisioni **ad hoc** mund të ftojë secilin zyrtar të Kosovës, që e sheh të arsyeshme, për të dëshmuar para tij. Kuvendi përcakton: procedurën, kohëzgjatjen e funksionimit të këtij komisioni, si dhe shpenzimet e mundshme të punës së tij (neni 71.2 i RP). Kur Kuvendi e sheh të arsyeshme, mund të formojë edhe komisione të tjera **ad hoc** për kryerjen e punëve brenda autorizimeve të tij (neni 71.4 i **RP**). Këto komisione, në fund për punën e tyre paraqesin raport me shkrim në Kuvend dhe propozojnë hapat të mëtejmë lidhur me çështjet që raportojnë (ta zëmë, propozojnë ndjekje penale, ndryshim të KKos, ligjeve dhe kështu me radhë, në varësi të gjetjeve që kanë bërë).

Nga të gjitha komisionet si më sipër, njëri prej tyre është më i rëndësishmi sepse mban rangun e komisionit të normuar me **KKos**. I vetmi komision që normohet shprehimisht me KKos, si në formë ashtu edhe në përmbajtje, është K**omisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve** (KDIK), që normohet me nenin 78 të **KKos**. **KDIK** është komision i përhershëm i Kuvendit. Ky komision përbëhet nga një e treta (1/3) e anëtarëve që përfaqësojnë grupin e deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin serb, nga një e treta (1/3) e anëtarëve që përfaqësojnë grupin

e deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë dhe një e treta (1/3) e anëtarëve nga komuniteti shumicë, të përfaqësuar në Kuvend (neni 78.1 i **KKos**). Me kërkesën e cilitdo anëtar të Kryesisë së Kuvendit, çdo ligj i propozuar do të dorëzohet në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve. **KDIK**, me shumicën e votave të anëtarëve të tij, do të vendos nëse do të bëjë rekomandime në lidhje me ligjin e propozuar brenda dy javësh (neni 78.2 i **KKos**). Për të siguruar që të drejtat dhe interesat e komuniteteve janë adresuar si duhet, **KDIK**-ja mund t'i bëjë rekomandime komisionit tjetër përkatës ose Kuvendit (neni 78.3 i **KKos**). Me nismën e vet, **KDIK-ja** mund të propozojë ligje dhe masa të tilla të tjera brenda përgjegjësive të Kuvendit, të cilat i konsideron se janë të duhura për të adresuar interesat e komuniteteve. Anëtarët e **KDIK-së** mund të japin mendime individuale (neni 78.4 **KKos**). Kryesia e Kuvendit, një komisioni tjetër, ose një grup i përbërë nga të paktën dhjetë (10) deputetë të Kuvendit mund të referojnë në KDIK një çështje për të dhënë mendim këshillimor (neni 78.5 i **KKos**).

Grupet parlamentare janë formë e organizimit të deputetëve për punën në Kuvendin e Kosovës. Me këtë emër nuk figurojnë në **KKos**, përkatësisht nuk normohen, siç nuk normohet as statusi kushtetues i partive politike, siç bëjnë disa kushtetuta në Evropë dhe gjetiu. Kjo, u mor vesh, nuk nënkupton asnjëherë se bëhet fjalë për devalvim të rolit kushtetues të partive politike dhe të vetë pluralizmit politik, që është alfa e omega e demokracisë kosovare dhe të rajonit të Ballkanit e Evropës në përgjithësi (me përjashtim të Bjellorusisë). Në **RP**, ndërkaq, **vetëm një nen normon punën e grupeve parlamentare dhe funksionimin e tyre**, neni 20. Deputetët mund të formojnë grup parlamentar sipas përkatësisë së tyre partiake ose të përcaktimeve programore (neni 20.1 i **RP**). Deputeti ka të drejtë të marrë pjesë në mënyrë të barabartë në një grup parlamentar, të tërhiqet nga grupi, ta formojë një grup të ri parlamentar, t'i bashkëngjitet një grupi tjetër ose të veprojë si deputet i pavarur. Për secilin rast deputeti është i obliguar që, për vendimin e tij, ta njoftojë me shkrim Kryetarin e Kuvendit (neni 20.2 i **RP**). Për krijimin e një grupi parlamentar nevojiten 5% e deputetëve të Kuvendit ose së paku gjashtë (6) deputetë. Në rastet kur numri i deputetëve, i anëtarëve të një grupi parlamentar, bie nën këtë minimum, grupi nuk ekziston më (neni 20.3 i **RP**). Grupi i ri, i formuar më vonë, nuk mund të ketë emër të njëjtë me ndonjë grup tjetër parlamentar (neni 20.4 i **RP**). Një deputet nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një grupi parlamentar (neni 20.5 i **RP**). Grupeve parlamentare u sigurohen hapësira të nevojshme dhe proporcionale, kushte dhe pajisje të nevojshme, si dhe një staf politik. Stafi politik i grupeve parlamentare për punën e vet shpërblehet në përputhje me vendim të Kryesisë (neni 20.6 i **RP**).

3.5. Mënyra e punës dhe e vendosjes

Kuvendi i Kosovës punon në **seanca të rregullta** dhe **seanca të jashtëzakonshme**, si dy forma të punës të përcaktuara me **KKos**, të operacionalizuara tutje me RP. Mbledhjet e Kuvendit të Kosovës janë publike (neni 68.1 i KKos). Mbledhjet e Kuvendit të Kosovës **mund të jenë të mbyllura** me kërkesën e Presidentit të Republikës së Kosovës, të Kryeministrit ose të një të tretës (1/3) së deputetëve, në rastet e përcaktuara me Rregulloren e Punës të Kuvendit. Vendimi miratohet në mënyrë të hapur e transparente dhe kërkon votën e dy të tretave (2/3) të deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë (neni 68.2 i KKos).

Seancat e rregullta, si formë e **punimeve vjetore**, Kuvendi i zhvillon në **dy sesione** (neni 69.1 i **KKos**). Sesioni pranveror fillon të hënën e tretë të muajit janar, kurse sesioni vjeshtor fillon të hënën e dytë të muajit shtator (neni 69.2 i KKos). Sesioni përbëhet nga mbledhjet plenare dhe nga mbledhjet e komisioneve. **Kryesia e Kuvendit** e cakton datën dhe vendos për rendin e ditës së mbledhjes së Kuvendit (neni 39.3 i **RP**). Kryetari i Kuvendit i njofton deputetët për datën e fillimit dhe atë të mbarimit të sesionit të punimeve të Kuvendit (neni 37 i RP). Seancat e komisioneve i thërret kryetari i komisionit përkatës (neni 64.1 i **RP**). **Kuvendi i Kosovës** mblidhet në **seancë të jashtëzakonshme** me kërkesë të Presidentit të Republikës, të Kryeministrit ose të një të tretës (1/3) të deputetëve (neni 69.4 i **KKos**). Edhe Kryesia mund të thërras mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit, për ta shqyrtuar një çështje të

ngutshme (neni 38.1 i RP). Kërkesa për mbledhje të jashtëzakonshme duhet t'i përmbajë çështjen që do të shqyrtohet dhe arsyetimin pse konsiderohet çështje e ngutshme dhe e rëndësishme (neni 38.3 i RP).

Për miratimin e rendit të ditës, Kuvendi duhet të ketë **kuorum**, që do të thotë se duhet të jenë të pranishëm më shumë se gjysma e të gjithë deputetëve të Kuvendit (neni 69.3 i **KKos**). Vetëm në fillim kërkohet **kuorumi** për punë, kurse më vonë ai nuk prish punë nëse ulet. Vendimet e mbledhjeve të Kuvendit, ndërkaq, konsiderohen të vlefshme vetëm në qoftë se në kohën kur për to është votuar, në sallë kanë qenë më shumë se gjysma e deputetëve të Kuvendit. Ligjet, vendimet dhe aktet e tjera të Kuvendit konsiderohen të miratuara nëse për to votojnë shumica e deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Përjashtim bëjnë rastet kur me Kushtetutën e Republikës së Kosovës parashihet ndryshe (neni 51.3 i **RP**). Ky përcaktim i **RP** nënkupton që, për amendamente kushtetuese, që kërkohen dy të tretat (2/3) të deputetëve të Kuvendit, përfshirë dy të tretat (2/3) të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë, si dhe për ligje me interes vital, kuorumi barazohet me votat që kërkohen për miratim të akteve të sipërcekura. Në mbledhje të Kuvendit marrin pjesë Qeveria dhe anëtarët e saj. Kur përfundon diskutimi për krejt pikat e rendit të ditës, në parim dhe në detaje, kryetari i Kuvendin e përfundon seancën.

Sipas rregullit, Kryesia Kuvendit, në bashkëpunimin me kryetarët e grupeve parlamentare, e përcakton rendin e ditës për mbledhjen e radhës së Kuvendit. Rendi i ditës u dërgohet deputetëve (neni 42.1 i **RP**). Në secilën mbledhje plenare, deputeti duke e njoftuar paraprakisht Kryetarin e Kuvendit, mund të propozojë që Kuvendi ta shqyrtojë menjëherë një çështje urgjente, e cila duhet te jetë në përputhje me përkufizimin e shtojcës së parë të shprehjeve të **RP**. Kryetari i Kuvendit ia mundëson deputetit të propozojë në Kuvend. Propozimi i tij vihet në votim. Nëse Kuvendi me votim vendos ta marrë çështjen parasysh, çështja radhitet në rendin e ditës së mbledhjes (neni 49. 1 i **RP**). Shtojca e parë, ndërkaq, definon shprehjet e përdorura në **RP**, përfshirë çështjen urgjente, të cilën e definon si një "çështje e ngutshme e paraqitur ndërkohë, që si e tillë nuk mund të parashtrohet në Kuvend, në mënyrë të rregullt, për të cilën vendos Kuvendi". Në disa prej kushtetutave të vendeve fqinje, në mënyrë shprehimore përcaktohet një formë e posaçme e punës së parlamentit, **pa rend të ditës**, dhe lidhet me situatën kur shteti gjendet në rrezik për shkak të luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme të shpallur ligjërisht nga organet kompetente. Në këto situata, të cilat, megjithatë, nuk përcaktohen qartë dhe shprehimisht në **KKos**, në vendet tjera përreth Kosovës parlamentet shqyrtojnë dhe vendosin mbi të gjitha çështjet që janë të rëndësishme për gjendjen e krizës së krijuar. Në rastin kosovar, mund të thuhet se shtojca e parë e **KKos**, që definon çështjen urgjente si më sipër, mund të interpretohet ashtu që lejon këtë formë të punës së **Kuvendit të Kosovës** pa rend dite, në rast të paraqitjes së rrethanave nga neni 131 i **KKos**.

Kryetari i Kuvendit kujdeset për rregull dhe mbarëvajtje të mbledhjeve në Kuvend (neni 41.1 i **RP**), përfshirë ditën e votimin, që sipas rregullit ndodhë pas përfundimit të diskutimit për pikën e rendit të ditës. Votimi bëhet në këto mënyra:

a) votimi i hapur, me ngritje të dorës: "për", "kundër" dhe "abstenim",
b) votimi i fshehtë ose
c) votimi i regjistruar, që e përfshinë votimin elektronik dhe
d) votimin duke e thirrur secilin deputet, veç e veç (neni 51.4 i **RP**).

3.6. Procedura ligjvënëse

Miratimi i ligjeve paraqet aktivitetin më të shpeshtë dhe, pas miratimit të kushtetutës, edhe veprimtarinë më të rëndësishme të **Kuvendit të Kosovës**. Rëndësia e procedurës së ligjvënies rrjedhë nga rëndësia që ka ligji për shoqërinë si një normativë thelbësore që normon marrëdhëniet e përditshme të një vendi. Shpeshtësia, ndërkaq, buron nga fakti i numrit të madh të ligjeve që miratohet çdo vit.

Kjo procedurë normohet në nivel parimor kushtetues me dispozitat e neneve 80 dhe 81 të **KKos**, kurse tutje zbërthehet me dispozitat e neneve 53-61 të kapitullit të trembëdhjetë të **RP**. Afërsisht kështu është gjendja edhe me kushtetutat e vendeve përreth Kosovës, të cilat, si akt të ndërmjetëm, disa prej tyre, kanë edhe ligjet organike për kuvendet e tyre. Kjo, megjithatë, nuk ndryshon faktin që pjesa dërrmuese e procedurës ligjvënëse në vendet fqinje me Kosovën gjendet jashtë tekstit kushtetues, praktikë që në disa vende evropiane nuk ndiqet. Kështu, ta zëmë, në **Itali**, **Portugali** e **Spanjë**, me kushtetutë normohen në detaje procedurat e miratimit të ligjeve. Kjo procedurë mund të jetë e **rregullt** dhe **urgjente**. Sipas procedurës urgjente, propozimi ligjit parashtrohet së paku 24 orë para seancës së Kuvendit, për arsye të paparashikuara apo kur mund të shkaktohet pasoja të pariparueshme për shtetin dhe qytetarët. Në procedurën urgjente, janë më të shkurtra afatet për paraqitje të amendamenteve, raporteve të komisionit përkatës kompetent, caktimin e rendit të ditës dhe vënien e vetos. Përkundër që bëhet fjalë për situata që duhet të jenë të rralla, praktika e prodhimit të ligjeve është më ndryshe – procedura urgjente në praktikë zbatohet mjaft shpesh. Procedura e rregullt dhe urgjente mund të jenë normale dhe të shkurtuara. Në procedurën e shkurtuar të ligjvënies, ka kohë përgjysmë më pak për shqyrtim të propozimligjit.

Procedura e prodhimit të ligjit kalon nëpër disa faza, brenda të cilave tri leximet e tij janë më të rëndësishmet. **Faza e parë** e procedurës ligjvënëse është **propozimi i ligjit**. Nismën për të propozuar ligje, mund ta marrë Presidenti nga fushëveprimtaria e saj/tij, Qeveria, deputetët e Kuvendit, ose më së paku dhjetëmijë qytetarë, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj (neni 79 i KKos lidhur me nenin 53.1 të RP). Në praktikë, ekzekutivi është propozuesi më i shpeshtë i ligjeve, thuajse krejt ligjet që miratohen janë të propozuara nga ai. Përmes propozimit të ligjeve që më pas votohen, ekzekutivi cakton dhe udhëheqë politikën e vet. Projektligji i dërguar në Kuvend, u përcillet deputetëve, komisioneve kompetente dhe Qeverisë (kur ajo nuk është propozues i tij) (neni 53.2 i **RP**). Qeveria duhet ta paraqes mendimin e vet me shkrim në afat prej një muaji nga dita e pranimit të projektligjit. Pas kalimit të këtij afati, Projektligji procedohet në Kuvend për shqyrtim (neni 53.3 i RP). Në rast se një projektligj propozohet nga së paku dhjetëmijë zgjedhës duhet të procedohet sipas procedurës së përcaktuar me ligj (neni 53.4 i RP). **Zyra për Propozime dhe Parashtresa** e evidencon dhe deputetëve ua shpërndan tekstin e projektligjit, më shkresë përcjellëse të nënshkruar nga sekretari i Kuvendit dhe e publikon në faqen elektronike të Kuvendit (neni 53.5 i RP).

Projektligji **duhet të ketë një përmbajtje të caktuar**, që do të thotë se me **RP** përcaktohen elementet thelbësore që duhet t'i përmbaj një tekst që mëton të shërbej si propozim i një ligji. Kushtet që duhet t'i plotësoj teksti që paraqitet në Kuvend si propozimligj janë:

- duhet të ketë shkresën shpjeguese për objektivat që synon t'i realizoj ligji, harmonizimin me legjislacionin në fuqi dhe arsyetimin e dispozitave të ligjit;
- duhet të ketë deklaratën për ndikimin buxhetor në vitin e parë dhe në vitet e mëpastajme; dhe, së fundi,
- duhet të ketë deklaratën për përafrimin dhe për harmonizimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE) dhe me tabelën krahasuese me aktet të cilave u referohet (neni 54.1 i RP).

Çdo projektligj që paraqitet në Kuvend duhet të jetë i hartuar në gjuhët: shqipe, serbe dhe angleze, në letër dhe në formë elektronike (neni 54.2 i RP). Zyra për Propozime dhe Parashtresa e Kuvendit e verifikon aspektin formal-juridik të projektligjit, e regjistron sipas rendit të paraqitur dhe ua dërgon deputetëve (neni 53.3 i RP). Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e parë të radhës, e cakton komisionin funksional - raportues për shqyrtim të projektligjit në parim (neni 53.4 i RP). Kur Kuvendi merr nismë për hartim të projektligjit, Kryesia e Kuvendit e kërkon mendimin e Qeverisë. Qeveria duhet të deklarohet për projektligjin brenda një muaji (neni 55.1 i RP). Nisma e deputetit, e komisionit ose e një grupi parlamentar, me ose pa mendimin e Qeverisë, radhitet për shqyrtim në mbledhje plenare, në afat prej dy muajve, nga dita e parashtrimit (neni 55.2 i RP). Nëse Kuvendi e miraton nismën, ngar-

kohet Qeveria që ta përgatis projektligjin brenda tre (3) muajve, nga dita e miratimit të nismës (neni 55.3 i RP).

Shqyrtimi i parë i një projektligji nuk mund të bëhet pa kaluar dy javë pune dhe as më vonë se katër javë pune, nga dita e shpërndarjes së tij (neni 56.1 i RP). Para shqyrtimit të parë të projektligjit në mbledhje plenare, komisioni funksional - raportues, i ngarkuar nga Kryesia e Kuvendit, e shqyrton projektligjin në parim. Komisioni i paraqet Kuvendit raport me rekomandime për miratim ose për mosmiratim të projektligjit në parim (neni 56.2 i RP). Shqyrtimi i parë i projektligjit nënkupton diskutimin dhe votimin e tij në parim (neni 56.3 i RP). Shqyrtimi i parë fillon me paraqitje të përfaqësuesit të propozuesit të projektligjit, vazhdon me paraqitje të raportuesit të komisionit funksional, të përfaqësuesve të grupeve parlamentare dhe të deputetëve. Shqyrtimi mbyllet me votimin në parim (neni 56.4 i RP). Propozuesi mund ta tërheq projektligjin gjatë shqyrtimit në Kuvend, deri para fillimit të votimit në shqyrtimin e dytë (neni 56.5 i RP).

Pas miratimit të projektligjit në **shqyrtim të parë**, Kuvendi i ngarkon për shqyrtim të mëtejshëm: Komisionin funksional, si komision raportues dhe komisionet: për Legjislacion dhe Gjyqësi, për Buxhet e Financa, për Integrime Evropiane, për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione dhe për të Drejtat e Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, si komisione të përhershme (neni 57.1 i RP). Në rastin kur projektligji rregullon çështje nga fushëveprimi i dy komisioneve funksionale, Kuvendi e ngarkon njërin prej tyre, si komision raportues (neni 57.2 i RP). Amendamente në projektligj mund të parashtroj deputeti, grupi parlamentar, komisioni parlamentar dhe Qeveria, në afat prej dy javësh pune nga miratimi në parim. Amendamentet i adresohen komisionit funksional – raportues (neni 57.3 i RP). Propozimi për amendamentin duhet të përmbaj: referimin ndaj dispozitës së projektligjit, formulimin e saktë të amendamentit dhe arsyetimin e ndryshimit të propozuar (neni 57.4 i RP). Propozimi i amendamenteve, që kanë implikime buxhetore, i dërgohet Komisionit për Buxhet dhe Financa, i cili duhet të deklarohet me raport, në afat prej pesë (5) ditëve pune, nga dita e pranimit (neni 57.5 i RP). Komisioni Funksional Kuvendit ia paraqet raportin me rekomandime për projektligjin brenda dy muajve, nga shqyrtimi i parë (neni 57.6 i RP). Në raste të veçanta, komisioni mund të kërkoj nga Kuvendi afat shtesë, deri në një muaj, për ta paraqitur raportin (neni 57.7 i RP). Komisionet e përhershme raportet e veta duhet t'ia paraqesin komisionit funksional, në afat prej dhjetë (10) ditë pune, nga dita e pranimit të amendamenteve nga Komisioni Funksional - Raportues (neni 57.8 i RP). Komisioni Funksional – Raportues, pasi e përfundon shqyrtimin, Kuvendit i paraqet raport me rekomandime, së paku pesë (5) ditë pune para shqyrtimit të dytë në mbledhje plenare. Në raport përfshihet edhe mendimi i komisioneve të përhershme, si dhe deklarimi për amendamentet e propozuara nga deputeti, nga komisioni, nga grupi parlamentar apo nga Qeveria (neni 57.9 i RP).

Shqyrtimi i dytë i projektligjit fillon me paraqitjen e raportit të komisionit funksional nga raportuesi. Pas paraqitjes së raportit, të drejtën e diskutimit e kanë përfaqësuesit e komisioneve të përhershme, përfaqësuesit e grupeve parlamentare, përfaqësuesit e Qeverisë dhe deputetët (neni 58.1 i RP). Shqyrtimi i dytë i projektligjit vazhdon me shqyrtimin dhe me votimin e amendamenteve të propozuara nga Komisioni Funksional – Raportues dhe të amendamenteve të propozuara nga komisionet e tjera, nga grupet parlamentare, nga Qeveria dhe nga deputetët (neni 58.2 i RP). Amendamentet shqyrtohen dhe votohen një nga një, sipas radhitjes së paraqitur, krahas tekstit të projektligjit (neni 58.3 i RP). Kur janë të propozuara dy amendamente për të njëjtin nen të projektligjit, që e përjashtojnë njëri-tjetrin, amendamenti i cili merr numrin më të madh të votave, konsiderohet i miratuar (neni 58.4 i RP). Pas shqyrtimit dhe miratimit të amendamenteve, të pasqyruara në tabelën krahasuese me tri kolona (teksti i projektligjit, i amendamenteve dhe teksti përfundimtar),votohet teksti i projektligjit në tërësi me ndryshimet e miratuara (neni 58.5 i RP).

Kur projektligji në shqyrtimin e dytë nuk merr numrin e duhur të votave për miratim, me kërkesë të propozuesit të projektligjit ose të komisionit funksional, Kuvendi vendos që projektligjin ta paraqes

edhe në **shqyrtimin e tretë**, së bashku me amendamentet e miratuara (neni 59.1 i RP). Amendamentet që janë shqyrtuar dhe që janë refuzuar në shqyrtimin e dytë, ose që janë të ngjashme me amendamentet në shqyrtimin e dytë, nuk mund të propozohen për shqyrtimin e tretë (neni 59.2 i RP). Procedura e shqyrtimit të amendamenteve plotësuese dhe procedura e shqyrtimit të projektligjit të ndryshuar në leximin e tretë, duhet të jenë në pajtim me nenin 58 të RP (neni 59.3 i RP).

Kuvendi ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare me ligj, në bazë të nenit 18 të **KKos** (neni 60.1 i RP). Projektligji për **ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare** i përmban tekstin e marrëveshjes ndërkombëtare, arsyet e ratifikimit dhe deklaratën financiare, në rastet kur ka implikime buxhetore (neni 60.2 i RP). Procedimi i projektligjit për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare është i veçantë dhe **i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi** (neni 60.3 i RP).

Pas mbarimit të shqyrtimit në parim dhe në detaje, votohet për propozimligjin në ditën e caktuar për një gjë të tillë. Deputetët votojnë për propozimligjin në parim, në detaje dhe për tekstin si tërësi. Ligjet miratohen me **shumicë të thjeshtë** të votave të deputetëve prezent, me kusht që në sallë janë prezent shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit, pra me supozim që ekziston kuorumi. Ligjet shprehimisht të përmendura (numëruara) në nenin 81 të **KKos**, të njohura si **ligjet me interes vital**, miratohen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve plus me shumicën e njëjtë të votave të deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë në shumicë. Asnjëri nga **ligjet me interes vital**, nuk mund t'i nënshtrohet referendumit (neni 81.2 i KKos.). Këto ligje janë për sa vijon:

(1) ligjet të cilat ndryshojnë kufijtë e komunave, themelojnë ose shuajnë komuna, përkufizojnë shtrirjen e pushteteve të komunave dhe pjesëmarrjen e tyre në marrëdhëniet ndërkomunale dhe tejkufitare;
(2) ligjet të cilat zbatojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, me përjashtim të atyre të përcaktuara me Kushtetutë;
(3) ligjet për përdorimin e gjuhëve;
(4) ligjet për zgjedhjet lokale;
(5) ligjet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe zonave të veçanta të mbrojtura;
(6) ligjet për liritë fetare ose për marrëveshjet me komunitetet fetare;
(7) ligjet për arsimin; dhe, së fundi,
(8) ligjet për përdorimin e simboleve, përfshirë simbolet e komuniteteve dhe për festat publike (neni 81.1 i **KKos**).

Shpallja e ligjeve është e drejtë dhe detyrë e Presidentit të Republikës. Ligji i miratuar nga Kuvendi nënshkruhet nga Kryetari i Kuvendit, në afat prej dhjetë ditë pune, nga dita e miratimit (neni 61.1 i RP). Më pas vjen shpallja e tij nga **Presidenti i Republikës së Kosovës**, brenda tetë (8) ditësh nga marrja ligjit të miratuar dhe nënshkruar nga Kryetari i Kuvendit (neni 80.2 i **KKos**). **Dekreti** mbi shpalljen e ligjit ka **karakter deklarativ**. Nëse Presidenti e kthen ligjin në Kuvend, ai/ajo duhet të theksojë arsyet e kthimit të ligjit. Presidenti të drejtën e kthimit të një ligji në Kuvend, mund ta ushtrojë vetëm një herë (neni 80.3 i **KKos**). Në **KKos** nuk përcaktohen arsyet për kthim të ligjit, por ato zakonisht kanë të bëjnë me vlerësimin e shefit të shtetit se ai është kundërkushtetues, kundër të drejtës dhe standardeve ndërkombëtare apo, thjesht, ligji nuk është i mirë sa duhet. Presidenti ka tetë (8) ditë afat nga marrja e ligjit për përdorimin e të drejtës së vetos pezulluese. Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, vendos për miratimin e ligjit të rikthyer nga Presidenti, dhe ligji përkatës konsiderohet i shpallur (neni 80.4 i **KKos**). Kjo nënkupton që është rrëzuar vetoja pezulluese e shefit të shtetit (nuk janë marrë parasysh arsyet e dhëna për kthim të ligjit prapa në Kuvend). Nëse Presidenti së Kosovës, brenda tetë (8) ditësh pas marrjes së ligjit, nuk merr asnjë vendim për shpalljen ose kthimin e tij, ligji konsiderohet i shpallur, pa nënshkrimin e saj/tij dhe publikohet në **Gazetën Zyrtare** (neni 80.5 i **KKos**). Në Kosovë, për dallim nga disa vende përreth, nuk ekziston mundësia

kushtetuese që një organ tjetër, ta zëmë, kryetari i parlamentit, të nënshkruaj ligjin të cilin shefi shtetit nuk e ka nënshkruar për çfarëdo arsye qoftë.

Pas shpalljes së ligjit, ai hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në **Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës**, përveç nëse me vet ligj nuk përcaktohet ndryshe. Me këtë ligji bëhet i njohur për publikun. Sikundër shihet, pra, nga dita e shpalljes e deri në hyrjen në fuqi të ligjit, në parim, duhet të kalojnë së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë (neni 80.6 i **KKos**). Kjo njihet si **vocatio legis.** U mor vesh, përjashtim bëjnë rastet kur vet ligjvënësi e ka përcaktuar një afat tjetër të hyrjes në fuqi të ligjit të shpallur (ose që konsiderohet i shpallur). Ky afat është i nevojshëm për të njoftuar publikun me dispozitat e ligjit. Përjashtimisht, ligji mund të hyj në fuqi ditën e miratimit, nëse për këtë ekzistojnë rrethanat të veçanta që arsyetojnë një hap të tillë dhe që janë të bëra të ditura ditën e miratimit të tij. As në **KKos** e as në **RP** nuk jepen arsyet ose rrethanat që arsyetojnë shkurtimin e **vocatio legis**. Kjo nënkupton që ato duhet të vlerësohen nga përfaqësuesit e sovranit për secilin rast veç e veç.

3.7. Shpërndarja

Të drejtës së organit përfaqësues për votim të mosbesimit të Qeverisë i kundërvihet e drejta e ekzekutivit për shpërndarje të Kuvendit para mandatit katërvjeçar. Shpërndarja e Kuvendit normohet me **KKos**, kryesisht në nenin e saj 82, që flet për shpërndarjen e organit përfaqësues. **KKos**, megjithatë, edhe në vendet tjera bën fjalë për shpërndarjen e Kuvendit (nenet 86.6 dhe 95.6 të **KKos**).

Dispozitat kushtetuese mbi shpërndarjen e Kuvendit, në tërësinë e tyre mund të ndahen në dy grupe: në grupin e parë janë dispozitat kur Kuvendi shpërbëhet, pra kur nuk ekziston asnjë **diskrecion** për Presidentin e Republikës për ruajtje të Kuvendit; në grupin e dytë, ndërkaq, janë rrethanat e përcaktuara kushtetuese që i japin një **hapësirë të butë diskrecionale** Presidentit të Republikës për të vendosur për shpërbërjen ose jo të Kuvendit. Qeveria nuk ka asnjë autorizim për shpërndarje të Kuvendit dhe as për shpalljen e zgjedhjeve.

Presidenti i Republikës **ex constitutionem** duhet të shpërndaj Kuvendin e Kosovës në këto raste:

(1) nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e caktimit të mandatarit nga Presidenti i Republikës së Kosovës, nuk mund të formohet Qeveria;
(2) nëse për shpërndarjen e Kuvendit votojnë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve, shpërndarja bëhet me dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës;
(3) nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e fillimit të procedurës së zgjedhjes, nuk zgjidhet Presidenti i Republikës së Kosovës (neni 82.1 i **KKos**).

Dekreti i Presidentit të Republikës në këto raste ka karakter thjesht **deklarativ**, sepse vetëm konstaton përmbushjen e kushteve të përcaktuara kushtetuese për shpërndarjen e Kuvendit. Nuk jepet asnjë arsyetim për këtë.

Kuvendi mund të shpërndahet nga Presidenti, pas **votimit të suksesshëm të mosbesimit** të Qeverisë (neni 82.2 i **KKos**). Sikundër shihet, **KKos** nuk flet për atë se çfarë ndodh nëse nuk pranohet kërkesa e kryeministrit për **votëbesim të qeverisë**, e paraqitur konform nenit 100.2 të KKos. As **RP** nuk ofron ndonjë dritë për ndriçim të kësaj situate, sepse dispozitat e saj flasin për të njëjtën gjë, përkatësisht për **mocionin e mosbesimit për Kryeministrin** (neni 30 i RP) dhe **mocionin e votëbesimit të Kryeministrit ndaj qeverisë** (neni 31 i RP). Në **KKos** bëhet fjalë për **mocionin e mosbesimit** ndaj Qeverisë, që mund ta kërkojnë një e treta (1/3) e deputetëve të Kuvendit, dhe për **kërkesën për votëbesim** që mund ta bëj vetë Kryeministri. Në dy rastet efekti kushtetues është i njëjtë, përkatësisht si kur **votohet mosbesimi**, ashtu edhe kur nuk pranohet kërkesa për **votëbesim** të Qeverisë. Ky efekt kushtetues konsiston në atë se vendi nuk shkon në zgjedhje me automatizëm: në dy situatat e sipërme Qeveria konsiderohet në dorëheqje, pra si kur votohet mosbesimi ashtu edhe kur nuk pranohet kërkesa për

votëbesim. Këtu Presidenti vishet me një **diskrecion të butë**, nisur nga fakti se kushtetutëbërësi kosovar në fjalinë nisëse të nenit 82.2 ka thënë se "Kuvendi mund të shpërndahet.. "., pra ai nuk shpërndahet detyrimisht. Kjo nënkupton se shefi shtetit duhet domosdo të konsultohet me forcat politike, për të verifikuar nëse mund të arrihet një shumicë e re për formim të një Qeverie të re (të pakicës ose shumicës së re). Vetëm atëherë kur kjo shumicë nuk sigurohet, ajo/ai mund të shpërndaj Kuvendin. Ky standard është krijuar me një vendim të **Gjykatës Kushtetuese**, me të cilën është interpretuar situata kushtetuese kur vendi ngelet pa Qeveri.[76] Një situatë e tillë, përkatësisht ngelja e vendit pa Qeveri, mund të ndodh sepse shefi ekzekutivit jep dorëheqje, shumica absolute e deputetëve ia **mohon besimin qeverisë**, qoftë kur besimi kërkohet nga një e treta (1/3) e deputetëve ose kur kërkohet nga vetë shefi ekzekutivit, shefi ekzekutivit vdes apo bëhet i paaftë për ushtrimin e detyrës së saj/tij si shef ekzekutivi. **KKos** nuk i përmend taksativisht këto situata kur vendi i shefit të ekzekutivit ngelet vakant, por përdor një shprehje gjenerike në fjalinë e parë të dispozitës së nenin 95.5, duke përmendur, përveç dorëheqjes, edhe arsye të tjera si shkak që posti i shefit të ekzekutivit ngelet i lirë.

4. Kuvendi Shqipërisë

Për Kuvendin e Shqipërisë, **Kushtetuta e Shqipërisë** (KShq) flet në pjesën e tretë (nenet 64-85). Në kreun e parë normohet zgjedhja dhe mandati i Kuvendit (nenet 64-67). Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë, të zgjedhur sipas një sistemi zgjedhjesh proporcional me konkurrim rajonal dhe prag kombëtar (neni 64.1 i **KShq**). Në shpërndarjen e mandateve marrin pjesë subjektet zgjedhore që arrijnë pragun kombëtar (neni 64.2 i **KShq**). Zgjedhësit gëzojnë të drejtën për të dhënë votë parapëlqyese për kandidatët e listave shumemërore. Kriteret dhe rregullat për zbatimin e sistemit zgjedhor, për caktimin e zonave zgjedhore, pragun kombëtar, numrin e mandateve për secilën zonë, shpërndarjen e mandateve dhe masën e shtrirjes së votimit parapëlqyes përcaktohen në ligjin për zgjedhjet. Ligji për zgjedhjet garanton që votimit parapëlqyes t'i nënshtrohen jo më pak se dy të tretat e listës shumemërore dhe të sigurojë përfaqësim gjinor (neni 64.3 i **KShq**).

Kuvendi zgjidhet çdo 4 vjet. Mandati i Kuvendit fillon me mbledhjen e parë të tij pas zgjedhjeve dhe përfundon në të njëjtën datë të të njëjtit muaj të vitit të katërt nga data e mbledhjes së parë. Në çdo rast, Kuvendi qëndron në detyrë deri në mbledhjen e parë të Kuvendit të ri të zgjedhur (neni 65.1 i **KShq**). Zgjedhjet për Kuvendin e ri zhvillohen në periudhën zgjedhore më të afërt që i paraprin datës së përfundimit të mandatit të Kuvendit. Periudhat zgjedhore dhe rregullat për thirrjen e zgjedhjeve për Kuvendin përcaktohen në ligjin për zgjedhjet (neni 65.2 i **KShq**). Në rast shpërndarjeje të Kuvendit para përfundimit të mandatit të plotë, zgjedhjet thirren jo më vonë se 45 ditë pas shpërndarjes së tij (neni 65.3 i **KShq**). Kuvendi nuk mund të nxjerr ligje gjatë periudhës 60 ditë para mbarimit të mandatit të tij deri në mbledhjen e parë të Kuvendit të ri, me përjashtim të rasteve të vendosjes së masave të jashtëzakonshme (neni 65.4 i **KShq**). Mandati i Kuvendit zgjatet vetëm në rast lufte dhe për aq kohë sa vazhdon ajo. Kur Kuvendi është i shpërndarë, ai rithirret vetiu (neni 66 i KShq).

Presidenti e mbledh Kuvendin e porsazgjedhur jo më parë se data e përfundimit të mandatit të Kuvendit paraardhës, por jo më vonë se 10 ditë pas mbarimit të këtij mandati. Kur Kuvendi paraardhës është shpërndarë para mbarimit të mandatit, Presidenti e mbledh Kuvendin e ri jo më vonë se 10 ditë pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve (neni 67.1 i **KShq**). Në rast se Presidenti nuk e ushtron këtë kompetencë, Kuvendi vetëmblidhet në ditën e dhjetë të afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni (neni 67.2 i **KShq**).

[76] *AKTGJYKIM në rastin nr. KO 72/20. Parashtrues: Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës Vlerësim i kushtetutshmërisë së Dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. 24/2020, të datës 30 prill 2020.* **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**. Prishtinë, 1 qershor 2020. Nr. ref.:AGJ 1574/20. Parag. 546-580 dhe pjesa operative e Aktgjykimit.

Kreu i dytë (nenet 68-73 i **KShq**) flet për deputetët. Kandidatët për deputetë paraqiten në nivel zone zgjedhore nga partitë politike ose nga zgjedhësit. Një kandidat mund të paraqitet vetëm për një nga subjektet propozuese, sipas kësaj pike. Rregullat për regjistrimin e kandidatëve për deputetë përcaktohen në ligjin për zgjedhjet (neni 68.1 i **KShq**). Në ligjin për zgjedhjet përcaktohen edhe kritere dhe rregulla të tjera të nevojshme për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve, duke përfshirë ato për regjistrimin e zgjedhësve, zhvillimin e fushatës zgjedhore, administrimin, vlefshmërinë e zgjedhjeve dhe shpalljen e rezultateve të tyre (neni 68.2 i **KShq**). Nuk mund të kandidojnë e as të zgjidhen deputetë, pa hequr dorë nga detyra: a) gjyqtarët, prokurorët; b) ushtarakët e shërbimit aktiv; c) punonjësit e policisë dhe të sigurimit kombëtar; ç) përfaqësuesit diplomatikë; d) kryetarët e bashkive dhe të komunave, si dhe prefektët në vendet ku kryejnë detyrat e tyre; dh) kryetarët dhe anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve; e) Presidenti dhe funksionarët e lartë të administratës shtetërore të parashikuar nga ligji (neni 69.1 i **KShq**). Mandati i fituar në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni është i pavlefshëm (neni 69.2 i **KShq**).

Deputetët përfaqësojnë popullin dhe nuk lidhen me asnjë mandat detyrues (neni 70.1 i **KShq**). Deputetët nuk mund të ushtrojnë njëkohësisht asnjë detyrë tjetër shtetërore, përveç asaj të anëtarit të Këshillit të Ministrave. Rastet e tjera të papajtueshmërisë caktohen me ligj (neni 70.2 i **KShq**). Deputetët nuk mund të kryejnë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri të këtyre (neni 70.3 i **KShq**). Për çdo shkelje të paragrafit 3 të këtij neni, me mocion të kryetarit të Kuvendit ose të një të dhjetës së anëtarëve të tij, Kuvendi vendos për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila konstaton papajtueshmërinë (neni 70.4 i **KShq**).

Mandati i deputetit fillon ditën që ai shpallet i zgjedhur nga komisioni përkatës i zgjedhjeve neni 71.1 i **KShq**). Mandati i deputetit mbaron ose është i pavlefshëm, sipas rastit: a) kur ai nuk bën betimin; b) kur heq dorë nga mandati; c) kur vërtetohet një nga kushtet e pazgjedhshmërisë ose papajtueshmërisë të parashikuara në nenet 69, 70 paragrafët 2 dhe 3; ç) kur mbaron mandati i Kuvendit; d) kur mungon pa arsye mbi 6 muaj rresht në Kuvend; dh) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi (neni 71.2 i **KShq**). Para fillimit të ushtrimit të mandatit deputetët bëjnë betimin në Kuvend (neni 72.3 i **KShq**).

Deputeti nuk mban përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe votat e dhëna prej tij në ushtrim të funksionit. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastin e shpifjes (neni 73.1 i KShq). Deputeti nuk mund të arrestohet ose t'i hiqet liria në çfarëdo lloj forme apo ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës, pa autorizimin e Kuvendit (neni 73.2 i KShq). Deputeti mund të ndalohet ose të arrestohet pa autorizim kur kapet në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi të rëndë. Prokurori i Përgjithshëm ose Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme njofton menjëherë Kuvendin, i cili, kur konstaton se nuk ka vend për procedim, vendos për heqjen e masës (neni 73. 3 i KShq). Për çështjet e parashikuara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, Kuvendi mund të diskutojë në seancë me dyer të mbyllura, për arsye të mbrojtjes së të dhënave. Vendimi merret me votim të hapur (neni 73.4 i KShq).

Kreu i tretë (nenet 74-80) i KShq rregullon organizimin dhe funksionimin e Kuvendit të Shqipërisë, në një mënyrë shumë të detajuar dhe ngjashëm me vendet tjera përreth Kosovës. Kuvendi i zhvillon punimet vjetore në dy sesione. Sesioni i parë fillon të hënën e tretë të janarit dhe sesioni i dytë të hënën e parë të shtatorit (neni 74.1 i **KShq**). Kuvendi mblidhet në sesion të jashtëzakonshëm, kur kërkohet nga Presidenti, nga Kryeministri ose nga një e pesta e të gjithë deputetëve (neni 74.2 i KShq). Sesionet e jashtëzakonshme thirren nga kryetari i Kuvendit në bazë të një rendi dite të përcaktuar (neni 74.3 i **KShq**).

Kuvendi zgjedh dhe shkarkon kryetarin e vet (neni 75.1 i KShq). Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve (neni 75.2 i KShq). Kryetari kryeson debatin, drejton punimet, siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe të anëtarëve të tij, si dhe

përfaqëson Kuvendin në marrëdhëniet me të tjerët (neni 76.1 i **KShq**). Nëpunësi më i lartë civil i Kuvendit është sekretari i përgjithshëm (neni 76.2 i **KShq**). Shërbimet e tjera të nevojshme për funksionimin e Kuvendit kryhen nga nëpunës të tjerë, siç përcaktohet në rregulloren e brendshme (neni 76.3 i **KShq**).

Kuvendi zgjedh nga gjiri i tij komisione të përhershme, si dhe mund të caktojë komisione të posaçme (neni 77.1 i **KShq**). Kuvendi ka të drejt dhe, me kërkesë të një të katërtës së të gjithë anëtarëve të tij, është i detyruar të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë. Përfundimet e tyre nuk janë detyruese për gjykatat, por mund t'i njoftohen prokurorisë, e cila i vlerëson sipas procedurës ligjore (neni 77.2 i **KShq**). Komisionet e hetimit veprojnë sipas procedurës së parashikuar me ligj (neni 77.3 i **KShq**).

Kuvendi vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar (neni 78.1 i **KShq**). Mbledhjet e deputetëve që mbahen pa u thirrur sipas rregullores, nuk sjellin asnjë pasojë (neni 78.2 i KShq).

Mbledhjet e Kuvendit bëhen të hapura (neni 79.1 i **KShq**). Me kërkesën e Presidentit të Republikës, të Kryeministrit ose të një të pestës së deputetëve mbledhjet e Kuvendit mund të bëhen të mbyllura, kur për këtë kanë votuar shumica e të gjithë anëtarëve të tij (neni 79.2 i **KShq**). Kryeministri dhe çdo anëtar tjetër i Këshillit të Ministrave është i detyruar t'u përgjigjet interpelancave dhe pyetjeve të deputetëve brenda tri javëve (neni 80.1 i **KShq**). Anëtari i Këshillit të Ministrave ka të drejt të marrë pjesë në mbledhjet e Kuvendit ose të komisioneve të tij; atij i jepet fjala sa herë që e kërkon (neni 80.2 i **KShq**). Drejtuesit e institucioneve shtetërore, me kërkesë të komisioneve parlamentare, japin shpjegime dhe informojnë për çështje të ndryshme të veprimtarisë së tyre për sa e lejon ligji (neni 80.3 i **KShq**).

Kreu i katërt dhe i fundit (nenet 81-85) i **KShq** rregullon procesin ligjvënës, në mënyrë shumë të ngjashme me Kosovën dhe vendet përreth. Të drejtën për të propozuar ligje e ka Këshilli i Ministrave, çdo deputet, si dhe 20 mijë zgjedhës (neni 81.1 i **KShq**). Miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit: a) ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve, të parashikuara nga Kushtetuta; b) ligji për shtetësinë; c) ligji për zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore; ç) ligji për referendumet; d) kodet; dh) ligji për gjendjen e jashtëzakonshme; e) ligji për statusin e funksionarëve publikë; ë) ligji për amnistinë; dhe f) ligji për ndarjen administrative të Republikës (neni 81.2 i **KShq**).

Propozimi i ligjeve, kur është rasti, duhet të shoqërohet kurdoherë me raportin që përligj shpenzimet financiare për zbatimin e tij (neni 82.1 i **KShq**). Asnjë projektligj joqeveritar që bën të nevojshme rritjen e shpenzimeve të buxhetit të shtetit ose që pakëson të ardhurat, nuk mund të miratohet pa marrë mendimin e Këshillit të Ministrave, i cili duhet të shprehet brenda 30 ditëve nga data e marrjes së projektligjit (neni 82.2 i **KShq**). Në qoftë se Këshilli i Ministrave nuk shprehet brenda afatit të mësipërm, projektligji kalon për shqyrtim sipas procedurës së zakonshme (neni 82.3 i **KShq**). Projektligji votohet tri herë: në parim, nen për nen dhe në tërësi (neni 83.1 i **KShq**). Kuvendi, me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose të një të pestës së të gjithë deputetëve, mund të shqyrtojë e të miratojë një projektligj me procedurë të përshpejtuar, por jo më parë se një javë nga fillimi i procedurës së shqyrtimit (neni 83.2 i **KShq**). Procedura e përshpejtuar nuk lejohet për shqyrtimin e projektligjeve të parashikuara në nenin 81 paragrafi 2, me përjashtim të nënparagrafit "dh" (neni 83.3 i **KShq**).

Presidenti shpallë ligjin e miratuar brenda 20 ditëve nga paraqitja e tij (neni 84.1 i **KShq**). Ligji quhet i shpallur, nëqoftëse Presidenti nuk ushtron të drejtat e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni dhe në paragrafin 1 të nenit 85 (neni 84.2 i **KShq**). Ligji hyn në fuqi me kalimin e jo më pak se 15 ditëve nga botimi i tij në Fletoren Zyrtare (neni 84.3 i **KShq**). Në rastet e masave të jashtëzakonshme, si dhe në rast nevoje e urgjence, kur Kuvendi vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve dhe Presidenti jep pëlqimin, ligji hyn në fuqi menjëherë, vetëm pasi të jetë njoftuar publikisht. Ligji duhet të botohet në numrin

më të parë të Fletores Zyrtare (neni 84.4 i **KShq**). Presidenti ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë (neni 85.1 i **KShq**). Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbë fuqinë, kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit (neni 85.2 i **KShq**).

5. Kuvendi Maqedonisë së Veriut

Pjesa e tretë (nenet 61 -78) e **Kushtetutës së Maqedonisë së Veriut** (KMVe), që flet për organizimin e pushtetit shtetëror, fillon me **Kuvendin e Maqedonisë së Veriut**. Kuvendi është organ përfaqësues i qytetarëve dhe bartës i pushtetit ligjvënës i Republikës (neni 61.1 i **KMVe**). Organizimi dhe funksionimi i tij rregullohen me Kushtetutën e Maqedonisë së Veriut (**KMVe**) dhe me Rregulloren e Punës (RrP) (neni 61.2 i **KMVe**). Kuvendin e përbëjnë 120 deri në 140 deputetë (neni 62.1 i **KMVe**). Deputetët zgjidhen në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë (neni 62.2 i **KMVe**). Deputeti i përfaqëson qytetarët dhe në Kuvend vendos sipas bindjes së tij (neni 62.3 i **KMVe**). Deputeti nuk mund të revokohet (neni 62.4. i **KMVe**). Mënyra dhe kushtet për zgjedhjen e deputetëve rregullohen me ligj, i cili nxirret me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve (neni 62.5 i **KMVe**). Ata zgjidhen për periudhë kohore prej katër vitesh. Mandatin e deputetëve e verifikon Kuvendi. Mandati fillon të rrjedhë nga seanca konstitutive e Kuvendit. Kuvendi i porsazgjedhur mblidhet në seancën konstitutive më së voni 20 ditë pas zgjedhjeve të mbajtura. Seancën konstitutive e thërret Kryetari i Kuvendit nga përbërja e mëparshme (neni 63.1 i **KMVe**). Në qoftë se seanca konstituive nuk thirret në afatin e paraparë, deputetët vetë mblidhen dhe e konstituojnë Kuvendin në ditën e 21-të nga dita e përfundimit të zgjedhjeve (neni 63.2 i **KMVe**). Zgjedhjet për deputetë në Kuvend mbahen në 90 ditët e fundit të mandatit të përbërjes së vjetër të deputetëve ose brenda afatit prej 60 ditësh nga dita e shpërndarjes së Kuvendit (neni 63.4 i **KMVe**). Mandati i deputetëve mund të zgjatet vetëm në rast të luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme (neni 63.5 i **KMVe**). Me ligj caktohet papajtueshmëria dhe pazgjedhshmëria e funksionit të deputetit në Kuvend me ushtrimin e funksioneve ose profesioneve të tjera publike (neni 63.6 i **KMVe**). Paragrafi i fundit i këtij neni rregullon shpërndarjen e Kuvendit, gjë e cila bëhet nëse për atë deklarohet shumica nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Neni 64 i **KMVe** normon imunitetin e deputetëve dhe çështjet tjera të statusit të tyre. Deputetët gëzojnë imunitet (neni 64.1 i **KMVe**). Deputeti nuk mund të thërritet në përgjegjësi penale ose të arrestohet për mendimin e shprehur ose për votimin në Kuvend (neni 64.2 i **KMVe**). Deputeti nuk mund të arrestohet pa pëlqimin e Kuvendit, përveç nëse kapet në kryerje e sipër të veprës penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg në kohëzgjatje prej së paku pesë vitesh (neni 64.3. i **KMVe**). Kuvendi mund të vendos të aplikohet imuniteti mbi deputetin edhe kur ai vet nuk thirret në të, nëse kjo është e nevojshme me qëllim të ushtrimit të funksionit të deputetit (neni 64.4 i **KMVe**). Gjatë kohës së mandatit deputetët nuk i nënshtrohen detyrimit në forcat e armatosura (neni 64.5 i **KMVe**). Deputeti ka të drejtë në kompensim të përcaktuar me ligj (neni 64.6 i **KMVe**).

Deputeti mund të paraqesë dorëheqje (neni 65.1 i **KMVe**). Deputeti dorëheqjen e paraqet personalisht në seancën e Kuvendit (neni 65.2 i **KMVe**). Deputetit i pushon mandati kur është dënuar për vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg në kohëzgjatje prej së paku pesë vitesh (neni 65.3 i **KMVe**). Deputetit mund t'i hiqet mandati kur është dënuar për vepër penale ose vepër tjetër të ndëshkueshme e cila e bën të padenjë për ta ushtruar funksionin e deputetit, si dhe kur mungon pa arsye për më tepër se gjashtë muaj në Kuvend. Heqjen e mandatit e bën Kuvendi me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve (neni 65.4 i **KMVe**).

Kuvendi është në punime të përhershme (neni 66.1 i **KMVe**). Kuvendi punon në seanca (neni 66.2 i **KMVe**). Seancat e Kuvendit i thërret Kryetari i Kuvendit (neni 66.3 i **KMVe**). Kuvendi nxjerr Rregulloren e punës me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve (neni 66.4 i **KMVe**).

Kuvendi nga radha e deputetëve e zgjedh kryetarin dhe një ose më shumë nënkryetarë, me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve (neni 67.1 i **KMVe**). Kryetari i Kuvendit e përfaqëson Ku-

vendin, kujdeset për zbatimin e RP të Kuvendit dhe ushtron punë të tjera të përcaktuara me **KMVe** dhe me RP Kuvendit (neni 67.2 i **KMVe**). Funksioni Kryetar i Kuvendit nuk pajtohet me ushtrimin e funksionit, profesionit tjetër publik ose funksionit në parti politike (neni 67.3 i **KMVe**). Kryetari i Kuvendit i shpall zgjedhjet për deputetë dhe për zgjedhjen e Presidentit të Republikës (neni 67.4 i **KMVe**).

Në nenin 68.1 të **KMVe përcaktohen kompetencat e Kuvendit, të cilat janë si vijon:** nxjerrja dhe ndryshimi **KMVe**; nxjerrja ligjeve dhe bërja interpretimit autentik të ligjeve; përcaktimi detyrimeve publike; nxjerrja e buxhetit të Republikës dhe llogarisë përfundimtare të buxhetit; nxjerrja planit hapësinor të Republikës; ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare; vendosja për luftën dhe paqen; marrja e vendimit për ndryshimin e kufijve të Republikës; marrja vendimit për aderim dhe dalje nga aleanca ose bashkësia me shtetet e tjera; shpallja referendumi; vendosja për rezervat e Republikës; themelimi këshillave; zgjedhja e qeverisë së Republikës; zgjedhja e gjyqtarëve të **Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë** (GJKMVe); zgjedhja dhe shkarkimi i gjyqtarëve; zgjedhja, emërimi dhe shkarkimi edhe i bartësve të tjerë të funksioneve publike dhe funksioneve të tjera të përcaktuara me **KMVe** dhe me ligj; ushtrimi kontrollit dhe mbikëqyrjes politike mbi qeverinë dhe mbi bartësit e tjerë të funksioneve publike të cilët përgjigjen para Kuvendit; dhënia e amnistisë, dhe, së fundi, kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me **KMVe.** Për materializimin e kompetencave të veta, Kuvendi nxjerr edhe vendime, deklarata, rezoluta, rekomandime dhe konkluzione (neni 68.2 i **KMVe**). Me amendamentin XV të KMVe, datë 16 nëntor 2001, kompetenca e Kuvendit për emërim të gjyqtarëve kushtetues ka ndryshuar: "Kuvendi i zgjedhë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese. Kuvendi zgjedhë gjashtë gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Kuvendi zgjedhë tre gjyqtarë me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me ç'rast medoemos duhet të ketë shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u takojnë bashkësive të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut". Me amendamentin XXIX në KMVe, datë 16 nëntor 2001, gjithashtu ka ndryshuar edhe mënyra e zgjedhjes së gjyqtarëve të rregullt dhe gjyqtarëve porotë, të cilët sot zgjidhen dhe shkarkohen nga **Këshilli Gjyqësor** i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Mënyra e punës së Kuvendit të **Maqedonisë së Veriut** nuk dallon në thelb nga mënyra e punës së kuvendeve përreth Kosovës. Kuvendi mund të punojë nëse në seancë merr pjesë shumica e numrit të përgjithshëm të deputetëve (neni 69.1 i **KMVe**). Kuvendi vendos me shumicë të votave të deputetëve të pranishëm, ndërsa më së paku me një të tretën nga numri i përgjithshëm i deputetëve, nëse me KMVe nuk është parashikuar shumicë e veçantë (neni 69.2 i **KMVe**). Këto dispozita janë zëvendësuar në tërësi me **amendamentin X** në **KMVe**, datë 16 nëntor 2001. Kuvendi mund të vendos nëse në seancë merr pjesë shumica e numrit të përgjithshëm të deputetëve. Kuvendi vendos me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe së paku me një të tretën e numrit të përgjithshëm të deputetëve, nëse me **KMVe** nuk është parashikuar shumicë e veçantë (paragrafi parë i amendamentit X). Për ligjet të cilët drejtpërsëdrejti kanë të bëjnë me kulturën, përdorimin e gjuhëve, arsimin, dokumentet personale dhe përdorimin e simboleve, Kuvendi vendos me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm, me ç'rast medoemos duhet të ketë shumicë të votave nga deputetët e pranishëm të cilët u takojnë bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë. Kontestin në lidhje me zbatimin e kësaj dispozite e zgjidh Komiteti për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive (paragrafi dytë i amendamentit X).

Seancat e Kuvendit janë publike (neni 70.1 i **KMVe**). Kuvendi mund të vendos të punojë pa prezencën e publikut me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve (neni 70.2 i **KMVe**).

Të drejtë për të propozuar nxjerrje të ligjit ka çdo deputet i Kuvendit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe së paku 10.000 zgjedhës neni 71.1 i **KMVe**). Iniciativë për nxjerrjen e ligjit propozuesve të autorizuar mund t'u paraqesë çdo qytetar, grup qytetarësh, institucione dhe shoqata (neni 71.2 i **KMVe**).

Interpelancë mund të parashtrohet për punën e secilit bartës të funksionit publik, Qeverisë dhe secilit anëtar të saj veç e veç, si dhe për çështjet nga puna e organeve shtetërore neni 72.1 i KMVe). Interpelancë mund të

paraqesin së paku pesë deputetë (neni 72.2 i Kmve). Pyetje parlamentare mund të parashtrojë çdo deputet (neni 72.3 i **KMVe**). Mënyra dhe procedura e paraqitjes dhe e diskutimit, lidhur me interpelancën dhe pyetjen e deputetit, rregullohen me RP (neni 72.4 i **KMVe**).

Kuvendi vendos për shpalljen e referendumit për çështje të caktuara nga kompetenca e tij me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve (neni 73.1 i **KMVe**). Vendimi në referendum është miratuar, nëse për të kanë votuar shumica e zgjedhësve të cilët kanë votuar, në qoftë se kanë votuar më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të zgjedhësve (neni 73.2 I **KMVe**). Kuvendi e ka për detyrë të shpall referendum kur propozim do të paraqesin së paku 150.000 zgjedhës (neni 73.3 i **KMVe**). Vendimi i miratuar në referendum është i detyrueshëm (neni 73.4 i **KMVe**).

Kuvendi merr vendim për ndryshimin e kufijve të Republikës me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve (neni 74.1 i **KMVe**). Vendimi për ndryshimin e kufirit të Republikës është miratuar në referendum, në qoftë se për të ka votuar shumica nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve (neni 74.2 i **KMVe**).
Ligjet shpallen me dekret (neni 75.1 i **KMVe**). Dekretin për shpalljen e ligjeve e nënshkruajnë Presidenti dhe Kryetari i Kuvendit (neni 75.2 i **KMVe**). Presidenti mund të vendos të mos e nënshkruaj dekretin për shpalljen e ligjit (neni 75.3 i **KMVe**). Kuvendi sërish e shqyrton ligjin dhe në qoftë se e miraton me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, Presidenti ka për detyrë ta nënshkruaj dekretin (neni 75.4 i **KMVe**). Presidenti e ka për detyrë ta nënshkruaj dekretin, në qoftë se sipas **KMVe**, ligji nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve (neni 75.5 i **KMVe**).

Kuvendi themelon trupa punues të përhershëm dhe të përkohshëm (neni 76.1 i **KMVe**). Kuvendi mund të themeloj komisione anketuese për të gjitha fushat dhe për çdo çështje me interes publik (neni 76.2 i **KMVe**). Propozim për themelimin e komisionit anketues mund të paraqesin së paku 20 deputetë (neni 76.3 i **KMVe**). Kuvendi themelon komision të përhershëm anketues për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarit (neni 76.4 i **KMVe**). Të dhënat e komisioneve anketuese janë bazë për inicimin e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së bartësve të funksioneve publike (neni 76.5 i **KMVe**).

Kuvendi e zgjedh Avokatin e Popullit (neni 77.1 i **KMVe**). Avokati i Popullit i mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve të cilat u janë cenuar nga organet e administratës shtetërore dhe nga organet e organizatat e tjera të cilat kanë autorizime publike (neni 77.2 i **KMVe**). Këto dy paragrafe të këtij neni janë zëvendësuar me amendamentin XI në KMVe, datë 16 nëntor 2001. Tani gjendja është ndryshe. Kuvendi e zgjedh Avokatin e Popullit me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me ç'rast duhet të ketë shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u takojnë bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë (paragrafi parë i amendamentit XI). Avokati i Popullit i mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve të cilat u janë cenuar nga organet e administratës shtetërore dhe nga organet e organizatat e tjera të cilat kanë autorizime publike. Avokati i Popullit i përkushton vëmendje të veçantë mbrojtjes së parimeve të mosdiskriminimit, të përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive në organet e pushtetit shtetëror, organet e njësive të vetadministrimit lokal dhe në institucionet dhe shërbimet publike (paragrafi dytë i amendamentit XI). Avokati i Popullit zgjidhet për periudhë kohore prej tetë vitesh, me të drejtë edhe për një zgjedhje (neni 77.3 i **KMVe**). Kushtet për zgjedhjen dhe shkarkimin, kompetencat dhe mënyra e punës së Avokatit të Popullit rregullohen me ligj (neni 77.4 i **KMVe**).

Kuvendi themelon Këshill për Marrëdhënie Ndëretnike (neni 78.1 i **KMVe**). Këshillin e përbëjnë: Kryetari i Kuvendit dhe nga dy anëtarë maqedonas, shqiptarë, turq, vlleh, romë dhe dy anëtarë nga kombësi të tjera në Maqedoni të Veriut (neni 78.2 i **KMVe**). Kryetari i Kuvendit është edhe kryetar i Këshillit (neni 78.3 i **KMVe**). Kuvendi i zgjedh anëtarët e Këshillit (neni 78.4 i KMVe). Këshilli i shqyrton çështjet e marrëdhënieve ndëretnike në Republikë dhe jep mendim dhe propozime për zg-

jidhjen e tyre (neni 78.5 i **KMVe**). Kuvendi është i detyruar t'i shqyrtoj mendimet dhe propozimet e Këshillit dhe të merr vendim në lidhje me to (neni 78.6 i **KMVe**). Ky nen është zëvendësuar në tërësi me amendamentin XII në KMVe, datë 16 nëntor 2001. Ky amendament ka vetëm një paragraf dhe duket kështu: "Kuvendi themelon Komitetin për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive. Komitetin e përbëjnë 19 anëtarë prej të cilëve nga shtatë anëtarë nga radhët e deputetëve maqedonas dhe shqiptarë të Kuvendit dhe nga një anëtar nga radhët e deputetëve turq, vlleh, romë, serbë dhe boshnjakë. Në qoftë se ndonjëra nga bashkësitë nuk ka deputet, **Avokati i Popullit**, pas konsultimeve me përfaqësues relevantë të atyre bashkësive, do t'i propozojë anëtarët e tjerë të Komitetit. Kuvendi i zgjedh anëtarët e Komitetit. Komiteti shqyrton çështje nga marrëdhëniet ndërmjet bashkësive në Republikë dhe jep mendime dhe propozime për zgjidhjen e tyre. Kuvendi është i detyruar t'i shqyrtojë mendimet dhe propozimet e Komitetit dhe të merr vendime lidhur me to. Në rast të kontestit lidhur me zbatimin e procedurës për votim në Kuvend, të përcaktuar me nenin 69 paragrafin 2 të **KMVe**, Komiteti vendos me shumicën e votave të anëtarëve, për atë se a do të zbatohet procedura. Me këtë amendament është shlyer pika 7 e nenit 84 të **KMVe** që i jepte të drejtë shefi të shtetit të këtij vendi për të propozuar anëtarët e Këshillit për Marrëdhënie Ndëretnike.

6. Kuvendi i Malit të Zi

Pjesa e tretë, **Kushtetuta e Malit të Zi** (KMZi) fillon me **Kuvendin e Malit të Zi** (nenet 82-94). Neni 82 numëron kompetencat e Kuvendit. Ato janë: miratimi i kushtetutës; miratimi i ligjeve; miratimi i dispozitave dhe akteve të tjera të përgjithshme (vendime, konkluzione, rezoluta, deklarata dhe rekomandime); shpallja e luftës dhe gjendjes së jashtëzakonshme, miratimi buxhetit dhe bilancit përfundimtar të buxhetit; miratimi i strategjisë së sigurisë dhe strategjisë së mbrojtjes; miratimi i planit zhvillimor dhe planit hapësinor; vendosja për dërgimin e forcave të ushtrisë së Malit të Zi në forcat ndërkombëtare; rregullimi sistemit të administratës shtetërore; ushtrimi i kontrollit ndaj ushtrisë dhe forcave të sigurisë; shpallja referendumit shtetëror; zgjedhja dhe shkarkimi kryetarit dhe anëtarëve të Qeverisë; zgjedhja dhe shkarkimi i kryetarit të Gjykatës Supreme dhe kryetarin e gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese (GJKMZi); emëron dhe shkarkon: kryeprokurorin e shtetit dhe prokurorët e shtetit, avokatin e popullit, të cilin **KMZi** e quan "Mbrojtësi i lirive dhe të drejtave të njeriut", guvernatorin e Bankës dhe anëtarët e Bordit të Bankës Qendrore, kryetarin dhe anëtarët e Senatit të Auditorit të Shtetit dhe bartësit tjerë të funksioneve të përcaktuar me ligj; vendosja mbi të drejtat e imuniteteve; dhënia e amnistisë; ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare; shpallja e huave popullore dhe vendosja për futjen borxh të Malit të Zi; disponimi me pasurinë shtetërore mbi vlerën e përcaktuar me ligj; kryerja edhe e punëve të tjera të përcaktuar me **KMZi** dhe ligj. Me amendamentin III në KMZi, datë 31 korrik 2013, KMZi ka humbur disa kompetenca: tani ai bën zgjedhjen dhe shkarkimin e gjyqtarëve të **GJKMZi**, jo edhe të kryetarit që tani zgjidhet nga radha e gjyqtarëve kushtetues, kryeprokurorin e shtetit, jo edhe prokurorët e shtetit që tani zgjidhen nga Këshilli Prokurorial, si dhe katër anëtarët e Këshillit Gjyqësor nga radha e juristëve të njohur.

Kuvendin e përbëjnë deputetët që zgjedhen me votë të drejtpërdrejtë (neni 83.1 i **KMZi**) dhe ka gjithsejtë 81 deputetë (neni 83.2 i **KMZi**), të cilët zgjidhen me mandat katërvjeçar (neni 84.1 i **KMZi**). Mandati Kuvendit mund të ndërpritet para kohës për të cilën është zgjedhur me shpërndarje dhe me shkurtimin e mandatit të tij (neni 84.2 i **KMZi**). Nëse mandati i Kuvendit përfundon gjatë gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme, mandati vazhdohet edhe për 90 ditë të tjera shtesë pas mbarimit të rrethanave që kanë çuar në gjendjen e tillë (neni 84.3 i **KMZi**). Mandati i Kuvendit mund të shkurtohet me propozim të Presidentit të Malit të Zi, Qeverisë ose së paku 25 deputetëve (neni 84.4 i **KMZi**). Deputeti orientohet dhe voton sipas bindjes së lirë (neni 85.1 i **KMZi**) dhe ka të drejt që funksionin e deputetit ta ushtroj në mënyrë profesionale (neni 85.2 i **KMZi**). Sikundër shihet, këtu bën fjalë për të drejtën e deputetit për të qenë profesional, si një mënyrë për të sforcuar mandatin e lirë të përfaqësuesve të popullit. Pas kësaj, në nenit 86 të **KMZi**, në një paragraf me katër nënparagrafe normohet imunitetit i deputetëve. Mandati para mbarimit përfundon në rastet kur: 1.

jep dorëheqje; 2. me vendim të formës së prerë dënohet me burg efektiv në kohëzgjatje më së paku gjashtë muaj; 3. me vendim të formës së prerë është privuar nga zotësia veprimit; dhe 4. Humb shtetësinë malazeze.

Mbledhjen e parë pas certifikimit të zgjedhjeve nacionale e thirr kryetari i Kuvendit nga përbërja paraprake, e cila mbahet më së voni 15 ditë nga shpallja e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve (neni 88 i **KMZi**). Kuvendi ka kryetarin dhe një ose më shumë nënkryetarë, të cilët i zgjedh nga përbërja e vet në mandat katërvjeçar (neni 89.1 i **KMZi**). Kryetari përfaqëson Kuvendin, thirr seancat e tij dhe i kryeson ato, kujdeset për zbatimin e Rregullores së Punës (RrP), shpall zgjedhjet për presidentin e **Malit të Zi** dhe kryen punë të tjera të përcaktuara me KMZi, ligj dhe **RP** të Kuvendit (neni 89.2 i **KMZi**). Nënkryetari zëvendëson kryetarin e Kuvendit në kryerjen e punëve kur vetë nuk ka mundësi t'i kryej ose ato punë që ia ka besuar si zëvendësim (neni 89.3 i KMZi). Kuvendi mblidhet në **sesione të rregullta** dhe **sesione të jashtëzakonshme** (neni 90.1 i KMZi). Seanca e rregullt mbahet dy herë në vit (neni 89.2 i **KMZi**). Sesioni i parë fillon ditën e parë të punës në muajin mars dhe vazhdon deri në korrik, kurse sesioni i dytë ditën e parë të punës në tetor dhe vazhdon deri në dhjetor (neni 90.3 i **KMZi**). Sesioni i jashtëzakonshëm thirret me kërkesën e presidentit të Malit të Zi, Qeverisë ose së paku një të tretës së numrit të deputetëve (neni 90.4 i **KMZi**).

Kuvendi vendos me shumicën e votave të atyre që janë prezent dhe votojnë, me kusht që në seancë të jenë më shumë se gjysma e deputetëve, përveç kur me **KMZi** përcaktohet ndryshe (neni 91.1 i **KMZi**). Me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, Kuvendi miraton ligjet me të cilat rregullohet: mënyra e realizimit të lirive dhe të drejtave të njeriut; shtetësia malazeze; referendumi' detyrimet materiale të qytetarëve; simbolet shtetërore, përdorimi dhe shfrytëzimi i simboleve shtetërore; mbrojtja dhe siguria; ushtria; themelimi, bashkimi dhe shuarja e komunave; shpallja e gjendjes së luftës dhe gjendjes së jashtëzakonshme; miratimi planit hapsinor; miratimi RrP; shpallja e referendumit shtetëror; vendosja për shkurtimin e mandatit; vendosja për shkarkim të presidenti të Malit të Zi; zgjedhja dhe shkarkimi i kryetarit dhe anëtarëve të Qeverisë dhe vendosja për besimin ndaj Qeverisë; zgjedhja dhe shkarkimi i kryetarit të Gjykatës Supreme, gjyqtarëve kushtetues dhe kryetarit të **GJKMZi**; caktimi dhe shkarkimi Avokatit të Popullit (neni 91.2 i **KMZi**). Me dy të tretat e votave të krejt deputetëve, Kuvendi vendos për ligjet që rregullojnë sistemin zgjedhor dhe të drejtat pasurore të të huajve (neni 91.3 i **KMZi**). Në votimin e parë me dy të tretat, në të dytin me votat e shumicës së krejt deputetëve së paku pas tre muajve, Kuvendi vendos për ligjet me të cilat rregullohet mënyra e realizimit të të drejtave të fituara minoritare dhe përdorimi i njësive të ushtrisë në forcat e armatosura (neni 91.4 i **KMZi**).

Kuvendi shpërndahet nëse nuk zgjidhet Qeveria brenda 90 ditëve nga dita kur presidenti Malit të Zi për herë të parë propozon mandatarin (neni 92.1 i KMZi). Nëse Kuvendi për një kohë të gjatë nuk kryen detyra e përcaktuara me KMZi, Qeveria mund të shpërndaj Kuvendin, por vetëm pasi të marrë mendimin e kryetarit të Kuvendit dhe shefave të grupeve parlamentare (neni 92.2 i KMZi). Kuvendi shpërndahet me dekret të presidentit të Republikës së Malit të Zi (neni 92.3 i KMZi). Kuvendi nuk mund të shpërndahet në gjendje lufte dhe gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, nëse është votuar mocioni votëbesimit të Qeverisë, si dhe gjatë tre muajve të parë pas konstituimit dhe tre muaj para mbarimit të mandatit (neni 92.4 i KMZi). Presidenti Malit të Zi shpall zgjedhjet ditën e nesërme pas shpërndarjes së Kuvendit (neni 92.5 i KMZi).

Propozimi i ligjeve dhe akteve të tjera rregullohet me nenin 93 të **KMZi.** Të drejtën e propozimit të tyre e kanë Qeveria dhe deputeti (neni 93.1 i **KMZi**). Këtë të drejt e kanë edhe gjashtë mijë zgjedhës, përmes deputetit të cilin ata vetë e autorizojnë (neni 93.2 i KMZi). Propozimin për shpalljen e referendumit shtetëror mund ta bëjnë: së paku 25 deputet, presidenti Malit të Zi, Qeveria ose së paku 10 % e qytetarëve me të drejt vote (neni 93.3 i **KMZi**).

Presidenti **Malit të Zi** është i detyruar të shpall ligjin në afat prej tetë ditëve nga dita e miratimit të tij, përkatësisht në afat prej tri ditësh në rastet kur ligji është miratuar me procedurë të shpejt, ose të njëjtin ta kthej në Kuvend për rivotim (neni 94.1 i **KMZi**). Presidenti ka për detyrë ta shpall ligjin e rivotuar (neni 94.2 i **KMZi**).

7. Kuvendi i Serbisë

Në pjesën e parë të **Kushtetutës së Serbisë** (KSerb) të vitit 2006, aktualisht në fuqi, flitet për rregullimin e pushtetit dhe fillohet me Kuvendin e Serbisë (nenet 98-110). Kuvendi definohet si trupi më i lartë përfaqësues në vend dhe si bartës i pushtetit kushtetutëbër**ës** dhe ligjvënës (neni 98 i KSerb). Për dallim nga vendet tjera përreth, në Serbi parash ikohet që Kuvendi të ketë ligj organik që rregullon organizimin dhe funksionimin e tij (neni 110 i KSerb).

Kompetencat e Kuvendit përcaktohen në nenin 99 të **KSerb**, në tre paragrafët e tij, ku i fundit është autorizues i kompetencave shtesë të këtij organi shtetëror serb. Sipas këtij neni, Kuvendi: nxjerr dhe ndryshon KSerb; vendos për ndryshimin e kufirit të Republikës së Serbisë; shpall referendumin republikan; ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare kur me ligj është i përcaktuar detyrimi për ratifikim; vendos për luftën dhe paqen dhe shpall gjendjen e luftës dhe gjendjen e jashtëzakonshme; mbikëqyr punën e shërbimeve të sigurisë; miraton ligje dhe akte të tjera të përgjithshme nga kompetenca e Republikës së Serbisë; jep pëlqimin paraprak në statutin e krahinës autonome (siç dihet në **KSerb** figuron si krahinë autonome edhe **Kosova**, por me një emërtim pezhorativ për shqiptarët, "Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë", emërtim ky kishtar nga Mesjeta serbe); miraton strategjinë e mbrojtjes; miraton planin e zhvillimit dhe planin hapësinor; miraton buxhetin dhe llogarinë përfundimtare të Republikës së Serbisë, me propozim të Qeverisë; jep amnisti për vepra penale. Në kuadër të kompetencave në sferën zgjedhore (neni 99.1 i **KSerb**), Kuvendi serb ka këto kompetenca: zgjedh Qeverinë, mbikëqyr punën e saj dhe vendos për ndërprerjen e mandatit të Qeverisë dhe ministrave; zgjedh dhe shkarkon gjyqtarët e **Gjykatës Kushtetuese** (GJKSerb); zgjedh kryetarin e **Gjykatës së Supreme (**GJSSerb), kryetarët e gjykatave, kryeprokurorin e shtetit, prokurorët e shtetit, gjyqtarët dhe zëvendësit e prokurorëve shtetërorë, në pajtim me **KSerb**; zgjedh dhe shkarkon guvernatorin e Bankës Popullore të Serbisë dhe mbikëqyr punën e tij; zgjedh dhe shkarkon Avokatin e Popullit, të cilin e quan "Mbrojtës i qytetarëve", dhe mbikëqyr punën e tij; zgjedh dhe shkarkon edhe funksionarët tjerë të përcaktuar me ligj (neni 99.2 i **KSerb**). Kuvendi kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me KSerb dhe ligj (neni 99.3 i **KSerb**).

Ngjashëm me Malin e Zi, me amendamentet e vitit 2021, Kuvendit të Serbisë iu janë ndryshuar disa kompetenca: me amendamentin III tani përcaktohet që me shumicën e dy të tretave të krejt deputetëve, zgjidhen katër anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe katër anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kurse me tri të pestat zgjidhet kryeprokurori i shtetit dhe vendos për ndërprerjen e funksionit të të njëjtit. Me amendamentin V të vitit të njëjtë, GjSKSerb ndryshon emrin dhe quhet vetëm Gjykatë Supreme. Për ndryshimet tjera në KSerb flasim kur të diskutojmë për sistemin e drejtësisë dhe **GJKSerb**, ashtu siç kanë evoluar ato ndryshime me amendamentet e vitit 2021.

Kuvendin e Serbisë e përbëjnë 250 deputetë, që zgjidhen në zgjedhje të drejtpërdrejta, me votim të fshehtë, në pajtim me ligjin (neni 100 i **KSerb**). Në **Kuvendin e Serbisë**, sipas paragrafit të dytë të këtij neni, sigurohet barazia dhe përfaqësimi i gjinive dhe përfaqësuesve të pakicave kombëtare, në pajtim me ligjin. Zgjedhjet për Kuvend i shpall presidenti i Serbisë, 90 ditë para mbarimit të mandatit të Kuvendit, ashtu që zgjedhjen përfundojnë në 60 ditët në vijim (neni 101.1 i **KSerb**). Seancën e parë të Kuvendit e thërret kryetari i Kuvendit nga përbërja paraprake, ashtu që seanca mbahet më së voni 30 ditë nga dita e shpalljes së rezultateve përfundimtare zgjedhore (neni 101.2 i **KSerb**). Kuvendi në mbledhjen e parë verifikon mandatet e deputetëve (neni 101.3 i **KSerb**). Konsiderohet se Kuvendi është konstitutar me verifikimin e mandateve të dy të tretave të deputetëve (neni 101.4 i **KSerb**). Në vendimin e dhënë lidhur me verifikimin e mandateve lejohet ankesa në **GJKSerb**, i cili sipas ankesës vepron brenda 72 orëve

(neni 101.5 i **KSerb**). Mandati i deputetëve fillon të llogaritet nga dita e verifikimit të mandatit në Kuvend dhe zgjat katër vite, përkatësisht deri në ndërprerjen e mandatit të deputetëve të përbërjes aktuale të Kuvendit (neni 102.1 i **KSerb**). Deputeti është i lirë që, nën kushtet e vëna nga ligji, pakthyeshëm të vë në dispoziocion të partisë me propozimin e së cilës është zgjedhur mandatin e vet (neni 102.2 i **KSerb**). Deputeti i Kuvendit të Serbisë nuk mund të jetë deputet në kuvendin e krahinës autonome, as funksionar në organet e pushtetit ekzekutiv dhe gjyqësor, as nuk mund të kryej funksione të tjera dhe detyra për të cilat me ligj është përcaktuar se përbëjnë konflikt të interesit (neni 102.3 i **KSerb**). Zgjedhja, ndërprerja e mandatit dhe pozita e deputetëve rregullohen me ligj (neni 102.4 i **KSerb**).

Deputeti gëzon **imunitet** (neni 103.1 i **KSerb**). Deputeti nuk mund të thirret në përgjegjësi penale ose në përgjegjësi tjetër për mendimin e shprehur ose votën e dhënë gjatë ushtrimit të funksionit të deputetit (neni 103.2 i **KSerb**). Deputeti që thirret në imunitet nuk mund të burgoset, as kundër tij nuk mund të niset procedura penale ose procedura tjetër në të cilën shqiptohet dënimi me burg, pa pëlqimin e Kuvendit të Serbisë (neni 103.3 i **KSerb**). Deputeti që është zënë në kryerje të veprës penale për të cilën parashikohet dënimi me burg më shumë se pesë vite mund të burgoset pa lejen e Kuvendit të Serbisë (neni 103.4 i **KSerb**). Në procedurën penale ose në procedurën tjetër në të cilën ngrihet çështja imunitetit, nuk rrjedhin afatet e parashikuara për atë procedurë (neni 103.5 i **KSerb**). Mosthirrja në imunitet nga ana e deputetit nuk përjashton të drejtën e Kuvendit për të vënë në jetë imunitetin e sfiduar (neni 103.6 i **KSerb**).

Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, nga radhët e veta zgjedh kryetarin dhe një ose më shumë nënkryetar (neni 104.1 i **KSerb**). Kryetari përfaqëson Kuvendin, thërret seancat e Kuvendit dhe kryeson me to, kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me KSerb dhe Rregulloren e Punës (RrP) (neni 104.2 i **KSerb**). Kuvendi miraton vendime me shumicën e votave të deputetëve, në një seancë ku janë prezent shumica e anëtarëve të tij (neni 105.1 i **KSerb**). Me shumicën e votave të krejt deputetëve, ndërkaq, Kuvendi: jep amnisti për vepra penale; shpall dhe anulon gjendjen e jashtëzakonshme; përcakton masat e shmangies nga liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve në kohë lufte dhe të gjendjes së jashtëzakonshme; miraton ligjin me të cilin **Republika e Serbisë** iu beson krahinave autonome dhe njësive të vetëqeverisjes lokale disa çështje nga kompetenca e saj; jep pëlqimin paraprak në statutin e krahinës autonome; vendos për **RrP-në**; heq imunitetin e deputetëve, presidentit të Republikës, anëtarëve të Qeverisë dhe Avokatit të Popullit; miraton buxhetin dhe llogarinë përfundimtare; zgjedh anëtarët e Qeverisë dhe vendos për ndërprerjen e mandatit të Qeverisë dhe ministrave; vendos për përgjigjen në interpelancë; zgjedh gjyqtarët e **GJKSerb** dhe vendos për shkarkimin dhe ndërprerjen e mandatit të tyre; zgjedh kryetarin e **GJSKSerb**, kryetarët e gjykatave, kryeprokurorin e shtetit, prokurorët e shtetit, dhe vendos për ndërprerjen e funksionit të tyre; zgjedh gjyqtarët dhe zëvendësit e prokurorëve shtetërorë, në pajtim me **KSerb**; zgjedh dhe shkarkon guvernatorin e Bankës Popullore të Serbisë, Këshillin e guvernatorëve dhe Avokatin e Popullit; kryen edhe disa kompetenca zgjedhore (neni 105.2 i **KSerb**). Gjithashtu me shumicën e votave të krejt deputetëve, Kuvendi miraton ligjet që kanë të bëjnë me sa vijon: referendumin dhe iniciativën popullore; gëzimi i të drejtave dhe lirive individuale dhe kolektive të pjesëtarëve të pakicave kombëtare; planin e zhvillimit dhe planin hapësinor; marrjen e borxhit publik; territorin e krahinave autonome dhe njësive të vetëqeverisjes lokale; lidhjen dhe ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare; çështje të tjera të përcaktuara me **KSerb** (neni 105.3 i **KSerb**).

Kuvendi mblidhet në **dy sesione** të rregullta në vit (neni 106.1 i KSerb). Sesioni i parë i rregullt nis ditën e parë të punës në mars, kurse e seanca e dytë e rregullt nis ditën e parë të punës në tetor. Sesioni i rregullt nuk mund të zgjat më shumë se 90 ditë (neni 106.2 i KSerb). Kuvendi takohet në sesion të jashtëzakonshëm me kërkesën e së paku një të tretës së deputetëve ose me kërkesë të Qeverisë, sipas një rendi të ditës paraprakisht të përcaktuar (neni 106.3 i KSerb). Kuvendi mblidhet pa ftesë pas shpalljes së gjendjes së luftës ose gjendje së jashtëzakonshme (neni 106.4 i KSerb).

E drejta e **propozimit të ligjit**, dispozitave të tjera dhe akteve të përgjithshme kanë secili deputet, Qeveria, Kuvendi i Krahinës Autonome ose së paku 30.000 zgjedhës. (neni 107.1 i **KSerb**). Avokati i Popullit dhe Banka Popullore e Serbisë kanë të drejtë të propozojnë ligje nga kompetenca e tyre (neni 107.2 i **KSerb**). **Referendumi** normohet me nenin 108. Me kërkesën e të gjithë deputetëve ose së paku 100.000 zgjedhësve, Kuvendi shpall referendum lidhur me një çështje nga kompetenca e tij, në pajtim me **KSerb** dhe ligjin (neni 108.1 i **KSerb**). Objekt i referendumit nuk mund të jenë detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare, ligjet që kanë të bëjnë me liri dhe të drejta njerëzore dhe të minoriteteve, ligjet mbi tatimin dhe ligjet tjera financiare, buxheti dhe llogaria përfundimtare, futja e gjendjes së jashtëzakonshme dhe amnistia si dhe çështjet që kanë të bëjnë me kompetencat zgjedhore të Kuvendit të Serbisë (neni 108.2 i **KSerb**).

Presidenti Serbisë, sipas propozimit të arsyetuar të Qeverisë, mund të **shpërndaj** Kuvendin (neni 109.1 i **KSerb**). Qeveria nuk mund të propozoj shpërndarjen e Kuvendit, nëse kundër saj është parashtruar propozimi për votim të mosbesimit ose nëse vetë ajo ka ngritur çështjen e votëbesimit ndaj saj (neni 109.2 i **KSerb**). Kuvendi shpërndahet nëse nuk zgjedh Qeverinë brenda 90 ditëve nga dita e konstitutimit (neni 109.3 i **KSerb**). Kuvendi nuk mund të shpërndahet gjatë kohës së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme (neni 109.4 i **KSerb**). Presidenti i Serbisë ka për detyrë të nxjerrë dekretin për shpërndarjen e Kuvendit në rastet e përcaktuara me KSerb (neni 109.5 i **KSerb**). Në të njëjtën kohë me shpërndarjen e Kuvendit, presidenti Serbisë shpall zgjedhjet për deputet, ashtu që zgjedhjet të kryhen më së largu 60 ditë nga dita e shpalljes së tyre (neno 109.6 i **KSerb**). Kuvendi që është i shpërndarë kryen punët në vijim ose vetëm ato që nuk mund të shtyhen, siç përcaktohet me ligj. Në rast të shpalljes së luftës dhe gjendjes së jashtëzakonshme, menjëherë rikthehet kompetenca e plotë e Kuvendit, që zgjat deri të përfundoj lufta, përkatësisht gjendja e jashtëzakonshme (neni 109.7 i **KSerb**).

8. Shefi i shtetit: kuptimi dhe origjina

Shefi i shtetit është në krye të shtetit. Në disa vende ka pushtet real, në të tjerat gëzon një pozitë formale, e privuar nga pushteti real. Nëse shefi i shtetit ka autorizime efektive të pushtetit ekzekutiv, një gjë e tillë varet nga **pozita e tij juridiko-kushtetuese**, **forma e pushtetit shtetëror** dhe **forma e qeverisjes**. Në këtë kuptim dallojmë shefin e fortë dhe të dobët të shtetit, shefin e shtetit në sistemet e pushtetit: presidencial, parlamentar, i përzier (gjysmëpresidencial) dhe kuvendor (sistemi i kuvendeve), pastaj, shefin e shtetit në republikë dhe shefin e shtetit në monarki. Për pozitën e presidentit të republikës, pra, përcaktues nuk është edhe mënyra e zgjedhjes së saj/tij.

Shefi i shtetit përfaqëson shtetin si tërësi politike dhe popullin e tij. Ai është simboli, fytyra e të gjithë qytetarëve, të cilit, në disa vende, i takon vetëm pak pushtet ekzekutiv (siç është rasti me monarkitë evropiane apo me republikat në sistemet parlamentare), apo i takon krejt pushteti ekzekutiv (siç është rasti me republikat në sistemet presidenciale). Në **strukturën monocefale** të pushtetit ekzekutiv, qeveria nuk ekziston në aspektin formal, që do të thotë se presidenti është presidenti i vetëm i pushtetit ekzekutiv. Në **strukturën bicefale** të pushtetit ekzekutiv ekzistojnë shefi i shtetit dhe qeveria, të cilat ndajnë mes veti autorizimet e këtij pushteti. Në **sistemin klasik parlamentar**, presidenti i republikës dhe monarku kanë vetëm pushtetin simbolik, kundrejt pushtetit real të qeverisë. Gjendja paraqitet ndryshe në **sistemet e përziera,** sistemet e parlamentarizmit të racionalizuar me presidentin e zgjedhur të republikës, dhe **sistemet gjysmëpresidenciale**, në të cilat shefi i shtetit ka një pjesë të madhe ose të vogël të pushtetit real ekzekutiv.

Shikuar nga këndi historik i origjinës, shefi i shtetit mund të konsiderohet si **organi më i vjetër shtetëror**, krahasuar me organet tjera në kuadër të ndarjes horizontale të pushtetit. Pa u futur në antikitet, hulumtimet tregojnë se në Mesjetë duhen kërkuar rrënjët e statusit aktual të monarkëve, përkatësisht në pozitën e sundimtarit mesjetar. Me ndryshimin e statusit të "pushtetit të parë", nga i cili janë marrë në mënyrë graduale autorizimet dhe janë bartur te organet tjera, kryesisht në parlament dhe qeveri, por edhe si pasojë e forcimit të pozitës së monarkut dhe koncentrimin e pushtetit real në një pikë, ka ardhur deri te formimi i pozitave

të ndryshme të shefit të shtetit, që sot njihen nëpër **Evropë** dhe më gjerë. E thënë me fjalë të tjera, pozita e shefit të shtetit sot gjendet mes dy pikave të skajshme. Në disa vende, ai është i dobët dhe i ngjashëm me feudalin në fillet e krijimit të monarkive feudale në shek. XI dhe XII.

Evoluimi i pozitës së **shefit të shtetit** lidhet me monarkun, marrë parasysh se deri në fund të shek. XVIII, republikat nuk kanë ekzistuar, me përjashtime të vogla (ish-Republika e **Dubrovnikut**/**Raguza**, **Venedi-ku**, **Zvicra**). Në të vërtetë, republikat kanë qenë të rralla deri në shek. XX. Shefit të shtetit me pushtet të kufizuar siç ekziston në monarkitë bashkëkohore evropiane i kanë paraprirë format e ndryshme shtetërore.

Në **monarkitë mesjetare** feudale (shek. XI-XV) ka ekzistuar një **partikularizëm** (dromcim) feudal dhe një pushtet i dobët qendror. Me një pozitë jo të fortë, monarku ka qenë pak më i spikatur nga feudalët tjerë, të cilët, të mbledhur në **kuvendet e feudalëve**, kanë kufizuar pushtetin e tij. Kjo ka qenë e dukshme në veçanti në sferën e caktimit të tatimeve. Mirëpo, feudalët e mëdhenj kanë qenë vasalë të kurorës, jo në bazë juridiko-kushtetuese por mbi bazën e marrëdhënieve kontraktuale (civilo-juridike). Të bashkuar, feudalët kanë qenë një pengesë e pakapërcyeshme në kufizimin e pushtetit të kurorës dhe, në të njëjtën kohë, një kërcënim politik për të. Monarku ka kryer thuajse të gjitha punët shtetërore, në kuadër të një aparati shtetëror të pazhvilluar. Me tejkalimin gradual të dromcimit feudal, pushteti qendror zmadhohet dhe centralizohet, rrethanë që ka çuar në krijimin e **monarkisë absolute** (shek. XV-XVIII), në të cilën vjen deri te rritja aq e madhe e pushtetit të kurorës, sa ajo përfaqëson e vetme vullnetin me relevancë politike, të cilin e kthen në ligj, kurse personi i monarkut barazohet me shtetin. Efekt refleksiv i kësaj rritjeje të pushtetit absolut të monarkut është thënia e njohur "shteti jam unë" ("L'**État**, c'est moi") e mbretit të Francës **Luigji XIV** (Louis le Grand: 1638-1715). Tani kuvendet e feudalëve rrallë mblidhen dhe shtyhen në plan të dytë, ose fare nuk mblidhen (ta zëmë ato në Francë nuk ishin mbledhur afër 200 vitet e fundit para Revolucionit të vitit 1789), kurse ministrat janë shërbëtor që ndihmojnë kurorën, ndaj së cilës janë politikisht përgjegjës në tërësi. Monarku, në vend të Zotit, përfaqëson sovranin dhe kryen, ose në emër të tij kryhen, të gjitha funksionet shtetërore të një aparati më të zhvilluar shtetëror kundrejt atij pararendës.[77]

Imponimi i monarkëve të Evropës i kushtetutave të para shënon periudhën e **monarkive kushtetuese**, fillimisht në Angli nga fundi i shek. XVII e më pastaj në vendet tjera përgjatë shekujve XVIII dhe XIX e deri më sot. Tani e tutje, në veçanti pas Kongresit të Vjenës (1815), monarkët evropian kanë pushtet shtetëror vetëm aq sa përcaktohet me kushtetutë nacionale.[78] Nga kjo periudhë, përkatësisht nga **Kongresi i Vjenës** e tutje, me deklarata dhe norma kushtetuese mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, përfaqësimin popullor dhe pozitën e organeve të tjera shtetërore, monarkia evropiane bëhet çdo herë e më demokratike. Në fillim, monarkia kushtetuese paraqitet si dualiste, në të cilën mbreti cakton ministrat, për të kaluar në trajtën e **monarkisë parlamentare**, ku mbreti shërben si një simbol shtetëror, shprehur me fjalët e **Adolf Tier** (Adolphe Thiers: 1797-1877), që nuk administron/qeverisë, ai mbretëron: "Le roi n'administre pas, ne gouverne pas, il règne".[79] Më këtë shprehje, **A. Tier** ka treguar anën balancuese të postit të shefit të shtetit në një demokraci kushtetuese parlamentare. Në këtë shkrim të tij, ai ka përshkruar mbretin si një person që ndan dhurata dhe merret me aspektet protokollare të **Monarkisë së Francës** së viteve '30 të shekullit XIX. Ky ideal i mishëruar në këtë moto përshkruan shefin e shtetit si një organ të tretë të veshur me pushtet pasiv

---

77 Cf. më shumë në Charles Sumner Lobingier, "Rise and Fall of Feudal Law". *Cornell Law Review* Vol. 18 Issue 2 (February 1933), fq. 192-231; Roland Mousnier, *La Monarchie absolue en Europe du Ve siècle à nos jours* (Presses Universitaires de France: Paris, 1982).

78 Philippe Lauvaux, "Le roi " *Pouvoirs* Vol. 136 No. 1 (2011) fq. 71-85 në fq. 71 dhe 81 (shkrimi flet për zhvillimin historik të **Monarkisë së Belgjikës**, nga aspekti komparativ evropian).

79 Adolphe Thiers, "Le roi n'administre pas, ne gouverne pas, il règne". *Le National* - 4 Février 1830. Në internet: http://evene.lefigaro.fr/citation/roi-administre-gouverne-regne-9991.php (shikuar më 8 dhjetor 2022). **Adolf Tier** ka qenë presidenti i parë i **Republikës së Tretë franceze** (1871-1872), që ka zëvendësuar **Perandorinë e Dytë franceze** (1852-1870), që u shkatërrua në luftën e saj me **Prusinë** (19 korrik 1870 - 10 maj 1871). Cf. për më shumë edhe në Alain Laquièze, "ADOLPHE THIERS THÉORICIEN DU RÉGIME PARLEMENTAIRE: Ses articles dans "Le National" en 1830" *Revue Française d'Histoire des Idées Politiques* No. 5 (1er semestre 1997), fq. 59-88.

dhe të ndërmjetëm, kurse qeverinë si një organ që tani rrjedh nga përfaqësimi popullor dhe vullneti politik i qytetarëve i shprehur në zgjedhje, e veshur me pushtet të plotë ekzekutiv.

Presidentin e parë të republikës, me pozitë të përcaktuar qartë me kushtetutë, e hasim për herë të parë në SHBA. Pozita e tij kushtetuese ngelet e pandryshuar për më shumë se dy shekuj (nga viti 1787) dhe ka shërbyer si themel mbi të cilin është ndërtuar një sistem i posaçëm presidencial, unik në botë.

8.1. Marrja e pushtetit

Ardhja në pushtet e shefit të shtetit varet nga **forma e shtetit** – a është shteti monarki apo republikë. Te republika, në pushtet **ligjërisht** vihet përmes zgjedhjeve, në të cilat zgjidhet presidenti i republikës, kurse te monarkia në pushtet ligjërisht vihet përmes trashëgimit, ku trashëgohet froni perandorak, mbretëror, sulltanor, i carit etj. Deri te funksioni i shefit të shtetit arrihet edhe përmes **rrugëve faktike**, jo të ligjshme, me uzurpim të pushtetit përmes forcës së armatosur. Shefi i tillë i shtetit është diktator kurse sistemi politik diktaturë. Shefi i shtetit është organ inokos, përbëhet nga individi. Në ndërkohë që te monarkitë, thuajse nuk ekziston përjashtimi nga natyra inokose (individuale) e shefit të shtetit, përkundër që në kohët paramoderne, ta zëmë, në **Bizant** kanë ekzistuar bashkësundimtarët (dy vëllezër kanë sunduar së bashku perandorinë bizantine), te republikat aty-këtu ekziston shefi kolektiv i shtetit. Dikur ka ekzistuar shefi kolektiv i shtetit në thirrje të konsullit (dy në **Romën** e vjetër, tre në **Francën** paranapoleonike), direktoratit (**Franca** revolucionare: 1789-1799), presidiumit dhe kryesisë (ish-**Bashkimi Sovjetik** dhe ish-**Jugosllavia**), kurse aktualisht ekziston si këshill ekzekutiv (**Zvicra**) dhe kryesi (**Bosnjë-Hercegovina**). Institucionin e shefit kolektiv të shtetit e karakterizon barazia e anëtarëve, kryesimi me rotacion, shpesh edhe vendosja njëzëri apo konsensuale.

Në formën e vjetër shtetërore, monarki, funksioni i shefit të shtetit trashëgohet, nuk ka zgjedhje dhe mandat, në fron qëndrohet përjetë (një rast i rrallë është **Malajzia**, ku monarku zgjidhet për pesë vjet). Me kushtetutë rregullohet trashëgimia e fronit (kurorës), ku zakonisht vlen parimi i lindjes së parë mashkull nga monarkët (**primogjenitura** ose **parësoria**). Në një numër të monarkive evropiane janë barazuar meshkujt me femra sa i përket të drejtës për trashëgim të fronit. Në rastet kur trashëgimtari i fronit nuk mund të merr kurorën sepse është i mitur, përkohësisht mungon ose për arsye të tjera nuk mund të ushtroj këtë të drejtë, në periudhën kalimtare vjen deri te formimi i **regjencës**, zakonisht të përbërë nga tre vetë.

Mënyra e ardhjes në pushtet përmes trashëgimisë së fronit, për rrjedhojë nënkupton edhe ekzistimin edhe të një statusi të posaçëm të personit të monarkut. Ajo/ai nuk është politikisht përgjegjës ("non-liability") dhe gëzon paprekshmëri ("non-violability"), përkatësisht posedon **imunitetin (lirimin) nga përgjegjësia** ("non-liability immunity") dhe **imunitetin e paprekshmërisë** ("inviolability immunity"). Kjo nënkupton se ajo/ai nuk mund të shkarkohet, përveç me vullnet (abdikimi), ose për shkak të paaftësisë së përhershme për ushtrim të funksionit, dhe as që mund të mbahet penalisht përgjegjës. Ajo që ligjërisht është e mundur ka të bëj me udhëheqjen e procedurave lidhur me pasurinë e monarkut, siç është, ta zëmë, e drejta për kompensim të dëmit, sigurimi nga dëmi dhe konteste të tjera civile.

Në republikë, pozita e shefit të shtetit është e zgjedhshme, atë e zgjedhin qytetarët, parlamenti ose një trup i posaçëm zgjedhor për një mandat të caktuar (përjetësia e funksionit të presidentit është e rrallë, ta zëmë në ish-Jugosllavi ose në Kinën komuniste aktualisht). Zgjedhshmëria tregon se presidenti është i zëvendësueshëm, përkatësisht politikisht i përgjegjshëm, kurse përgjegjësia juridiko-penale e saj/tij është relative, zakonisht vetëm gjatë kohës sa zgjat mandati.

Kushtet për zgjedhjen për president të republikës mund të ndahen në dy grupe: **të përgjithshme** dhe **të veçanta**. Të parat përbëhen nga të drejtat zgjedhore pasive. Ato zakonisht janë: mosha madhore, shtetësia, zotësia veprimit, vendbanimi. Për shkak të rëndësisë së funksionit të presidentit të republikës, në shumë vende kërkohen edhe kushte të veçanta. Ato më së shpeshti kanë të bëjnë me **vjetërsinë** e kandidatit për

president (Algjeria: 40; Austria, Rusia, SHBA: 35 vjet; Gjermania 40; Italia: 50 etj.). Vitet janë prezumim i pjekurisë psikike dhe përvojës jetësore të kandidatit. Përveç moshës së vjetërsisë, kushtet e posaçme kanë të bëjnë me **vendbanimin** për një kohë të caktuar në vendin në të cilin hidhet kandidatura (Angola: 10; Armenia: 10; Meksiko: 20; SHBA: 14 vjet; Rusia: 10; Koreja Jugut: 10 etj.), shtetësinë e fituar me lindje, jo me natyralizim (ta zëmë, në SHBA kërkohet shtetësia e fituar me lindje, jo me natyralizim; kusht të njëjtë kanë edhe Brazili, Finlanda, Kolumbia etj.). Kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta nuk konsiderohen të përshtatshëm për kandidim (**jozgjedhshmëria**).

Kushtet e veçanta për zgjedhje në postin e presidentit të republikës mund të jenë të formuluara edhe në mënyrë **negative**. Ato nuk guxojnë të shfaqen dhe kanë të bëjnë me sa vijon: ndalimin e kandidimit të serishëm, ndalimi i kandidimit i personave të caktuar dhe mospërputhshmëria e funksioneve (jokompatibiliteti) të caktuara me funksionin e presidentit. Më së shpeshti personit të njëjtë i ndalohet të kandidojë me shumë se dy herë për president të republikës. Kjo përcaktohet me kushtetutë si **kufizim preventiv** me qëllim të ruajtjes së rendit demokratik nga pushteti personal dhe personifikimi i funksionit presidencial. Kufizimi shkon deri aty ku lejohet vetëm një mandat (**Meksiko**). Kufizimi vetëm në dy mandate mund të zbutet me formulimin sipas të cilit lejohen "më së shumti dy mandate të njëpasnjëshme", që nënkupton se shefi i shtetit që është zgjedhur dy herë mund të kandidojë edhe për të tretën herë pas një pauze, së paku të një mandati (ta zëmë: Argjentina, Rusia etj.). Në të kaluarën, pjesëtarët e dinastive të përmbysura mbretërore nuk kanë pasur të drejtën pasive zgjedhore (Austria, Italia, ish-Jugosllavia etj.), kurse sot kjo vlen në disa vende për personat që janë të dënuar me humbjen e të drejtave civile (Gjermania) apo janë persona të dënuar penalisht (SHBA). Një formë e ashpër mospërputhshmërisë së funksioneve ekziston nëse me kushtetutë apo ligj përcaktohet që për vlefshmërinë e kandidaturës për president, kandidati duhet paraprakisht të braktisë funksionin aktual apo punën (ta zëmë, funksionin e avokatit të popullit ose punën e avokatit privat).

Zgjedhja e presidentit të republikës me kushtetutë normohet vetëm në themel, pra vetëm bazat e zgjedhjes, të cilat zakonisht kanë të bëjnë me kushtet e kandidimit, mënyrën e zgjedhjes, mandatin, ndërprerjen e funksionit. Dispozita të detajuara mbi procedurën e zgjedhjes gjenden në ligj ose në rregulloren e punës së parlamentit, në rastet kur ai bën zgjedhjen e presidentit të republikës.

Zgjedhja e presidentit të republikës drejtpërdrejt nga qytetarët, burimisht është krijuar në vendet me sistem presidencial, sipas modelit të SHBA-së, por ekziston edhe në sistemet e përziera. Të gjithë qytetarët me të drejtën aktive zgjedhore zgjedhin presidentin e republikës, sipas rregullit me një shumicë absolute të votuesve që kanë dalë në zgjedhje. Nëse kjo shumicë absolute nuk fitohet në rrethin e parë, atëherë organizohet rrethi dytë i zgjedhjeve me dy kandidatët që kanë marrë më së shumti vota në rrethin e parë dhe fiton ai që merr më së shumti vota. Në disa vende për vlefshmërinë e kësaj procedure kërkohet që në zgjedhje të dalin mbi gjysma e krejt votuesve të regjistruar, në mënyrë që presidentit të zgjedhur t'i sigurohet sa më shumë legjitimitet.

Procedurë e veçantë e zgjedhjes së drejtpërdrejtë të presidentit ekziston në SHBA përmes zgjedhjes me **kolegj elektoral** ("electoral college"). Këtu votuesit së pari zgjedhin elektorët (538 sosh), për të cilët dihet paraprakisht se si do të votojnë për president në të ardhmen. Kjo nënkupton se ai kandidat që merr më së shumti elektor të zgjedhur (së paku 270 sosh) fiton në zgjedhje. Elektorët praktikisht nuk vendosin për zgjedhjen, por vetëm shërbejnë si **transmetues të vullnetit të zgjedhësve të tyre**, arsye kjo përse këto zgjedhje presidenciale konsiderohen të **drejtpërdrejta**. Për shkak të kombinimit të sistemit mazhoritar zgjedhor dhe listave zgjedhore të elektorëve, që janë të posaçme në secilin shtet federal (kush fiton më shumë vota, merr të gjithë elektorët e atij shteti federal), ekziston mundësia që kandidati të marr më shumë vota të kolegjit elektoral dhe të fitoj, në ndërkohë që ka fituar më pak vota të votuesve të drejtpërdrejtë (kështu ka ndodhur historikisht në zgjedhjet presidenciale në **SHBA** në vitet: 1876, 1888, 2000 dhe 2016).

Zgjedhja e tërthortë e presidentit të republikës kryhet në parlament (Armenia, Greqia, Hungaria etj.) apo në një trup të posaçëm të formuar për atë qëllim, në një lloj konvente zgjedhore (Gjermania, Estonia, Italia

etj.). Në parlamentin dydhomësh, sipas rregullit të dyja dhomat marrin pjesë në zgjedhjen e presidentit të republikës (Italia), mirëpo ekzistojnë vende ku dhoma e sipërme nuk merr pjesë (Gjermania). Zakonisht votimi për kandidatët është i shumëfishtë, deri të fitohet shumica e nevojshme e votave të përfaqësuesve. Në zgjedhjet e tërthorta, presidenti fiton më pak legjitimitet demokratik, krahasuar me zgjedhjet e drejtpërdrejta. Për pasojë, pozita politike e përgjithshme e presidentit të zgjedhur në mënyrë të tërthortë është më e dobët. Ndoshta kjo është arsyeja pse në **Evropë** zgjedhja e tërthortë e presidentit të republikës është shumë më i rrallë.

Më marrjen e funksionit **shefi i shtetit** nuk mund të kryej asnjë **funksion tjetër publik** ose **veprimtari profesionale**, konform parimit të ndarjes së pushtetit dhe dispozitave konkrete kushtetuese (ta zëmë, nuk mund të jetë deputet ose gjyqtar). Në disa vende ndalohet edhe ushtrimi i **funksioneve politike** (të jetë lider i partisë politike) apo anëtarësimi në parti politike. Ekzistojnë zgjidhje kushtetuese ku **fuzionohet** (shkrihet) pushteti ekzekutiv, ashtu që shefi i shtetit në të njëjtën kohë është edhe **shef i qeverisë** (**Zvicra**). Kjo duhet të dallohet nga **sistemi gjysmëpresidencial** francez ose **sistemi amerikan**: në rastin e parë, ekziston posti i kryeministrit dhe është i ndarë nga posti i presidentit të republikës, që është në të njëjtën kohë kreu i shtetit dhe i pushtetit ekzekutiv; në rastin e dytë, ndërkaq, nuk ekziston fare posti i kryeministrit, por vetëm ai i presidentit të republikës, që është shef shteti dhe shef qeverie.

8.2. Mandati i Presidentit të Republikës

Për dallim nga monarku që gëzon funksionin përjetë, apo diktatori që posedon me pushtetin përderisa ka forcën me vete, president e ka të kufizuar mandatin në pikëpamje kohore. Kohëzgjatja e tij dhe mundësia juridike për zgjedhje të serishme në atë funksion, mund të jenë të rëndësishme e vendimtare për pozitën e dobët ose të fortë të presidentit të republikës.

Mandati i presidentit të republikës fillon me dhënien e betimit, që përfaqëson hapin e fundit dhe solemn të marrjes së funksionit. Kjo njihet me emrin standard **inaugurimi presidentit të republikës**. Presidenti i zgjedhur zakonisht betohet në kushtetutë (dhe/ose në librin e shenjtë fetar). Këtij akti i paraprinë një ceremoni e shkurtër ose e gjatë, e cila zhvillohet në parlament ose në ambient të hapur, në prani të ministrave, deputetëve dhe funksionarëve të lartë shtetëror, mysafirëve dhe publikut. Për nga gjatësia dhe ceremoniali, më të njohurat janë inaugurimet e presidentëve amerikanë, me mbi një milion të pranishëm, me betimin para presidentit të **GJSAm**.

Për nga kohëzgjatja, mandati presidencial mund të jetë i njëjtë me mandatin e parlamentit ose më i gjatë. Në rastet kur mandatet e kohëzgjatjes janë të njëjtë dhe iu takojnë opsioneve të ndryshme politike, atëherë zvogëlohen mundësitë për kohabitim, përkatësisht për qeverisje të njëjtë mes, nga njëra anë, qeverisë dhe shumicës parlamentare dhe, nga ana tjetër, presidentit të republikës. Mandati më i gjatë i presidentit të republikës siguron kontinuitetin e pushtetit, për shkak se mandati është më i gjatë dhe përfshinë edhe periudhën e zgjedhjeve parlamentare.

Mandati i shefit të shtetit **zakonisht nuk është më i shkurtër se katër vjet**, siç është rasti me, ta zëmë, Argjentinën, Brazilin, SHBA-në, Islandën etj. Përjashtim nga kjo është shteti i vogël **Nauru** në Mikronezi të Oqeanisë, kurse në **Zvicër** mandati presidentit është njëvjeçar. Më së shpeshti, mandati është pesë vite (ta zëmë, në Algjeri, Francë, Gjermani, Indi etj.). Në një numër më të vogël të shteteve, ai mandat është pesë vite (ta zëmë, në Austri, Etiopi, Rusi, Meksiko, Venezuelë, etj.), kurse në të tjerat edhe shtatë vite (ta zëmë, në Itali, Irlandë, Izrael, Kamerun etj.). Gjatësia e mandatit presidencial është një kategori e ndryshueshme dhe mund të korrigjohet në vartësi të rrethanave të ndryshuara politike. Kështu, ta zëmë, në Francë, nga viti 2000, mandati tradicional shtatëvjeçar është ndryshuar në një mandat pesëvjeçar; ngjashëm ka ndodhur edhe në Rusi në vitin 2008, ku mandati katërvjeçar është kthyer në një mandat gjashtëvjeçar etj.

Funksioni i presidentit të republikës përfundon rregullisht, me kalimin e afatit për të cilën është zgjedhur. Para kalimit të këtij afati, shpallen zgjedhjet e reja presidenciale ose zgjedhja kryhet në parlament. Ditëve të fundit të mandatit bëhet pranim-dorëzimi i detyrës mes presidentit të vjetër dhe presidentit të ri dhe më këtë ruhet **vazhdimësia** e funksionit.

Presidentit mund t'i ndërpritet mandati para kohës për të cilën është zgjedhur. Këtu bëhet fjalë për situata jo të rregullta të ndërprerjes së funksionit dhe, si të tilla, janë më të rralla krahasuar me shfrytëzimin e mandatit të plotë kohor. Në këto raste pushojnë së ekzistuari kushtet për ushtrim të funksionit që kanë të bëjnë me vetë presidentin e republikës, siç janë: humbja e zotësisë së veprimit, paaftësia e përhershme shkaku i sëmundjes, humbja e shtetësisë, vdekja. Do të jetë më i shkurtër edhe në rastet e shkarkimit, revokimit ose impeachmeant-it, nëse vërtetohet se ka shkelur kushtetutën gjatë ushtrimit të funksionit, ka kryer ndonjë vepër të rëndë penale ose është zënë në flagrancë të veprës së caktuar penale.

Vendi i ngelur **vakant** për shkaqet si më sipër, plotësohet në mënyrën e përcaktuar paraprakisht me kushtetutë. Kur së bashku me presidentin zgjidhet edhe nënkryetari (ose zëvendësi), në rastet e ndërprerjes së parakohshme të mandatit, nënkryetari do të merr funksionin e presidentit dhe ushtron atë deri në fund të mandatit të ngelur (**SHBA**). Zëvendësimi i presidentit të republikës mund të kufizohet në disa muaj, përkatësisht deri në zgjedhjen e presidentit të ri të republikës, kohë në të cilën ushtrimin e funksionit e kryen një zyrtarë tjetër i lartë shtetëror. Ajo/ai mund të jetë **kryetari parlamentit** (**Hungaria, Kroacia**, **Portugalia, Sllovenia**), **kryetari dhomës së lartë** (**Franca**, **Gjermania**, **Italia, Pakistani**), **kryetari qeverisë** (në **Austri** përkohësisht, por nëse zgjat më shumë, atëherë kryetari dhomës së lartë), **qeveria** (në **Francë**, nëse presidenti Senatit është i penguar), në **Pakistan**, nëse kryetari Senatit është i penguar për çfarëdo arsye, atëherë kryetari i Asamblesë Nacionale kryen funksionin e presidentit), **ministri i brendshëm dhe sigurisë publike** (**Kili**), **kryetari i parlamentit** ose **kryeministri** (**Moldavia**) dhe kështu me radhë. Në këto raste, praktikisht vjen deri te bashkimi i pushtetit, përkatësisht deri te fuzionimi i funksioneve, që do të thotë se ky zëvendësim është i pranueshëm vetëm për një kohë të caktuar (përkohësisht). Në monarki, këtë funksion e kryen **regjenca**, pra kur për çfarëdo arsye monarku nuk është në gjendje të kryej funksionet mbretërore.

Autorizimi i personit që zëvendëson presidentin e republikës mund të jetë me kapacitet të plotë, që do të thotë se posedon të gjitha kompetencat si presidenti i zgjedhur (**Algjeria, India, SHBA**, **Turqia**). Kur zyrtari i lartë shtetëror që ushtron përkohësisht funksionin e presidentit të republikës vjen nga dega tjetër e pushtetit ose nga ekzekutivi, ajo/ai, sipas rregullit, nuk gëzon kapacitetin e plotë të të drejtave dhe detyrimeve të presidentit të republikës. Kështu, ta zëmë, nuk ka të drejt të **shpërndaj parlamentin** dhe **shpall referendumin** (**Franca**, **Polonia**, **Portugalia**, **Rusia**), nuk ka të **drejtën e vetos** (**Serbia**), as të drejtën për paraqitjen e propozimit për **ndryshim të kushtetutës** (**Rusia**). Në disa vende, ajo/ai mund të kryej vetëm punët që kërkojnë prezencën fizike, siç është nënshkrimi i dokumenteve (**Gjermania**). Në ndërkohë që zëvendëson presidentin e republikës kryetari i parlamentit nuk mund të kryej detyrat si **deputet** dhe si **kryetar i parlamentit** (**Hungaria, India**, **Portugalia**).

8.3. Kompetenca

Cili do të jetë vëllimi i pushtetit ekzekutiv me të cilin do të disponoj shefi i shtetit, varet nga sistemi politik i përcaktuar me kushtetutë. Pozitën e presidentit e ndërtojnë disa institute, kurse vëllimi i kompetencave me të cilat disponon varet nga **disa faktorë**, siç janë: zgjedhja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë, kohëzgjatja dhe mundësia e përtëritjes së mandatit, mënyra e shkarkimit, kurse vendimtare është sa dhe çfarë janë kompetencat e qeverisë së vendit. Fuqinë politike të presidentit të republikës e kufizon në veçanti e drejta e **kundërfirmës e qeverisë**. Kjo nënkupton që presidenti nuk mund të sjell asnjë akt të vlefshëm juridikisht nëse nuk është i furnizuar me pëlqimin me shkrim të dhënë nga kryeministri ose ministrat përkatës të qeverisë.

Në **sistemin presidencial të pushtetit**, presidenti posedon me krejt pushtetin ekzekutiv. Meqë nuk është e mundur që një person të kryej krejt funksionet e tilla shkaku i vëllimit, veçanërisht në shtetet e mëdha si Brazili, Meksiko, SHBA etj., atëherë shefi i shtetit rrethohet me sekretarë, ndihmës dhe këshilltarë, të ngarkuar me operativën në resorët përkatës të ekzekutivit, ngjashëm siç janë ministrat në një qeveri. Në **sistemet e përziera të pushtetit**, presidenti është një organ i spikatur i pushtetit ekzekutiv që rri mbi qeverinë, apo së paku në baraspeshë me qeverinë. Në **sistemet parlamentare të pushtetit**, ndërkaq, pushteti ekzekutiv është kryesisht ose në tërësi në duart e qeverisë, siç është rasti me monarkitë evropiane por edhe disa sisteme të tjera republikane.

Autorizimet e shefit të shtetit **mund të klasifikohen në dy grupe**: në grupin e parë mund të futen **prerogativat tradicionale** që nuk përfaqësojnë pushtetin apo fuqinë reale ekzekutive, kurse në të dytën hyjnë **prerogativat jotradicionale**, ato që përfaqësojnë pushtetin real ekzekutiv. Brenda grupit të parë, sipas traditës, shefi i shtetit përfaqëson shtetin ndaj botës së jashtme - komunikon me shefat e shteteve dhe qeverive, organizatat ndërkombëtare, negocion dhe lidh marrëveshje ndërkombëtare, pranon letrat kredenciale dhe letrat e tërheqjes së përfaqësuesve diplomatik të shteteve të huaja dhe organizatave ndërkombëtare (misioneve). Shefi shtetit, brenda këtyre prerogativave tradicionale, përfaqëson popullin edhe në marrëdhëniet e brendshme politike. Shefi i shtetit është komandanti suprem ushtarak ose është në krye të këshillit ushtarak, trupit kolektiv që ka detyrimin e komandimit me ushtrinë. Lidhur me këtë, shefi i shtetit miraton urdhra operativë, shpall mobilizimin dhe gjendjen e luftës, gradon dhe dekoron oficerët. Shefi i shtetit shpall zgjedhjet parlamentare sipas kushteve të përcaktuara me kushtetutë (Italia), ose vetëm zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare (**Finlanda**). E drejtë e tij tradicionale është dhënia e dekoratave dhe mirënjohjeve individëve dhe institucioneve. Pa pushtet real janë edhe autorizimet për sa vijon: shpallja e ligjit (kur nuk ka të drejtën e vetos), shpallja e referendumit me propozim të qeverisë, shpërndarja e parlamentit sipas propozimit të qeverisë që është i detyrueshëm për te, pra kur për këtë nuk vendos meritorisht për shpërndarjen por ka detyrim për të nxjerr dekretin për shpërndarje sipas fuqisë së kushtetutës (per constitutionem), propozimi mandatarit për formimin e qeverisë, që duhet detyrimisht t'i jepet liderit të shumicës parlamentare (**Britania e Madhe**). Një autorizim i posaçëm tradicional është ushtrimi i funksionit, ku me nxjerrjen e akteve mbi faljen e personave, shefi shtetit vepron si pushtet konkret gjyqësor, qoftë gjatë gjykimit (**abolicioni**), apo pas nxjerrjes së vendimit të formës së prerë (**falja**).

Pushtetin real ekzekutiv, shefi i shtetit e realizon përmes të **drejtave të ndryshme konkrete që i ka në disponim**. Në mesin e tyre hyjnë: caktimi dhe udhëheqja me politikën shtetërore (SHBA), e drejta e thirrjes dhe kryesimit me mbledhjet e qeverisë (Franca), e drejta në procedurën e ligjvënies – propozimi i ligjeve, vetoja pezulluese dhe absolute, e drejta për të vendosur mbi mandatarin për formimin e qeverisë, thirrjen dhe shpërndarjen e parlamentit, shpalljen e referendumit. Në autorizime reale të tij janë edhe e drejta që, krahas mandatarit, të propozoj dhe emëroj gjyqtarë, gjyqtarë kushtetues, të kryesoj organin e pushtetit të drejtësisë (shembuj të këtyre kompetencave ekzistojnë në Francë, Hungari, Itali, SHBA).

Në kohë të krizave është e dëshirueshme që vendimmarrja të jetë e shpejtë dhe, nëse ka mundësi, të kryhen nga një vend. Shefi i shtetit ka potencialin e veprimit të menjëhershëm – pa harmonizim, shqyrtim e debat, gjë që, për këtë arsye, me kushtetutë i caktohen e drejta për shpallje të gjendjes së jashtëzakonshme dhe gjendjes së luftës dhe të trajtave të tjera të krizës dhe të nxjerr **dekrete me fuqi ligjore**, me të cilat rregullohet gjendja e krizës, derisa të zgjasin rrethanat që e shkaktojnë atë.

8.4. Përgjegjësia

Kur bëhet fjalë për përgjegjësinë e shefit të shtetit, dallimet më të mëdha ekzistojnë mes monarkisë dhe republikës. Monarku nuk është përgjegjës për veprimet e veta, konform maksimës së njohur

se ajo/ai kurrë nuk mund të gaboj ("The King Can Do No Wrong").[80] Monarku nuk përgjigjet fare **politikisht** për punën e gabuar dhe jo me vend, as nuk mund të zëvendësohet (largohet) nëse shkel kushtetutën dhe ligjin. Krejt kjo është e mundur për shkak se shefi i monarkisë parlamentare është i zhveshur (privuar) nga pushtetit ekzekutiv në tërësi. Ai ka vetëm funksione formale përmes të cilave mbretëron, por nuk vendos. Ka të drejta që janë vjetruar ashtu që më edhe nuk i përdorë. Në aspektin **tekniko-juridik** përgjegjësinë për aktet e kurorës e merr qeveria apo ministri me kundërfirmën e vet dhe kjo mund të çojë në votimin e mosbesimit ndaj bashkënënshkruesit nga ana e parlamentit. Në rastin e monarkut, gjithashtu nuk ekziston as përgjegjësia **penalo-juridike**, që rrjedh nga aktet e kundërligjshme. Kjo përgjegjësi, si një relikt historik që akoma është ruajtur, është trashëguar nga koha kur monarku, si përfaqësues i pushtetit hyjnor dhe sovranitetit, është konsideruar juridikisht i paprekshëm nga gjyqet e përbotshme (laike). Përgjegjësia juridike e monarkut mund të kërkohet vetëm në sferën e përgjegjësisë **civilo-juridike** që ka të bëj me të drejtat dhe detyrat lidhur me pasurinë e kurorës.

Për dallim nga monarku, **përgjegjësia e presidentit të republikës** ekziston në dy anët – **politike** dhe **juridike**. Presidenti që zgjidhet drejtpërdrejt nga populli, politikisht përgjigjet ndaj votuesve. Ata në zgjedhjet e radhës, praktikisht vlerësojnë punën e tij, ashtu që votojnë për të ose kundërkandidatin respektiv. Mosvotimi në funksionin e njëjtë paraqet përgjigje meritore për përgjegjësinë politike të presidentit të republikës, një ndëshkim (dënim) për punën e dobët dhe vendimet e gabuara. Presidentit të republikës mund t'i caktohet përgjegjësia politike edhe më herët, gjatë kohës sa i zgjat mandati, që mund të çojë në shkarkimin ose revokimin e tij. Si rregull, vendimin për këtë e merr subjekti i njëjtë që e ka zgjedhur, por ekzistojnë edhe shembuj kur kjo nuk është kështu.

Për shkak të stabilitetit të funksionit të presidentit, procedura e shkarkimit është më e vështirë dhe me më shumë kërkesa në krahasim me zgjedhjen. Vendimin përfundimtar mund ta jap **parlamenti** (Austria, Irlanda), **gjykata kushtetuese** (Sllovenia, Kroacia), **përbërja e zgjeruar e gjykatës kushtetuese** (Italia), një gjykatë e posaçme për **impeachment** (Finlanda), gjykata supreme (Brazili), parlamenti dhe qytetarët (Serbia sipas Kushtetutës së vitit 1990).

Deri te shkarkimi ose revokimi nuk mund të vije nëse për këtë nuk janë përcaktuar paraprakisht kushtet dhe rrethanat nën të cilat duhet të ndodhin ato. Në kushtetutë zakonisht jepet arsyeja dhe shkaku abstrakt, siç është: shkelja e kushtetutës, sjellja e pahijshme dhe e papranueshme, tradhtia e lartë. Në këtë procedurë, që për nga natyra është politike, presidenti do të largohet nëse një shumicë e duhur e qytetarëve, deputetëve ose gjyqtarëve ka konstatuar se ka pasur shkelje. Pas kësaj, nëse në shkeljen e kushtetutës nga presidenti ose në tradhtinë e lartë ekzistojnë edhe elemente të figurës së veprës penale, ai do të gjykohet nga gjykata penale. Por gjykimi tani bëhet jo ndaj presidentit të republikës, por ndaj një qytetari të zakonshëm.

---

[80] Kjo shprehje ekziston nga Mesjeta dhe shekujt e parë të modernitetit (shek. XVI dhe XVII), kur monarkët kishin pushtet absolut. Rasti më emblematik i përdorimit të kësaj shprehjeje si mbrojtje, përkatësisht i përdorimit të saj në mbrojtje të imunitetit vetjak të monarkut për veprimet e kryera në emër të kurorës, është ai i vitit 1649 me mbretin anglez **Çarls Stjuart** (Charles of England: 1600-1649). Thirrja në këtë maksimë, megjithatë, nuk e ndihmoi atë nga ekzekutimi nën akuzat për tradhti të lartë. Deri në këtë kohë, gjykimi i monarkut kishte qenë një diçka absurde, që nuk mund të ndodhte asnjëherë. Maksima kishte funksionuar mirë deri kur **Gjykata e Lartë**, e formuar nga Dhoma e Ulët e cunguar e Parlamentit anglez, përkatësisht 59 komisionerët (gjyqtarët) e saj, nënshkruan dënimin me vdekje për mbretin **Çarls** të dinastisë **Stjuart.** Deri në nxjerrjen e ligjit të vitit 1947, që ka normuar procedurat e kurorës britanike, gjendja ka qenë jo fort e qartë sa i përket kësaj maksime, që ka shprehur idenë e imunitetit absolut të monarkëve anglezë/britanikë përgjatë shekujve. Kjo ka qenë e kundërt me maksimën në SHBA, që askush nuk është mbi ligjin, për të reflektuar se imuniteti presidencial ka kufijtë e vet qartësisht të përcaktuar nga rendi juridik-kushtetues amerikan. Cf. më shumë për këtë institut, lindjen dhe zhvillimin e tij, në Janelle Greenberg, "Our Grand Maxim of State, 'The King Can Do No Wrong" *History of Political Thought* Vol. 12 No. 2 (Summer 1991), fq. 209-228; Joyce Lee Malcolm, "Doing No Wrong: Law, Liberty, and the Constraint of Kings" *Journal of British Studies* Vo. 38 No. 2 (1999), fq. 161-186.

Presidentin e republikës nga përgjegjësia juridiko-penale për shkelje të ligjit e mbron imuniteti. Sikur deputetët, presidenti gëzon **imunitet material** të papërgjegjshmërisë që është i përhershëm dhe **imunitet procedural** të pacenueshmërisë që vlen paralel së bashku me mandatin. Pas mandatin, presidenti republikës qëndron nën ligjin si çdo qytetar tjetër. Lidhur me përgjegjësinë civile-juridike të presidentit të republikës, as nuk shtrohet çështja - ai mund të jetë palë në procedurë civile, me të gjitha të drejtat e detyrimet e palës në një procedurë të tillë.

Mënyrë e posaçme e konstatimit të përgjegjësisë së shefit të shtetit është **impeachement**-i, që ekziston në të drejtën anglo-saksone dhe në shtetet me sistem presidencial të pushtetit. Në **SHBA**, presidenti gjykohet sipas rregullave të procedurës gjyqësore: ngrihet aktakuza ("articles of impeachment"), nxirren provat, merren në pyetje kryqëzore dëshmitarët, por krejt kjo bëhet nga organet jogjyqësore. Dhoma përfaqësuese e **Kongresit** ngreh aktakuzën, kurse gjykimin e bën Dhoma e lartë (Senati). Në fund, Senati voton mbi atë nëse presidenti ka kryer vepër konkrete penale (ta zëmë, dëshmia e rrejshme, obstruksioni drejtësisë etj.) dhe për këtë shkak duhet të shkarkohet, për çka nevojiten së paku dy të tretat e krejt senatorëve. Kjo nënkupton, pra, që procedura e shkarkimit nis për shkaqe juridike, përkatësisht për shkak të një vepre penale konkrete, zhvillohet një procedurë juridike që ngjason me procedurën gjyqësore, kurse shqiptohet një sanksion politik – shkarkimi (në katër procedura të **impeachment**-it të kryera deri më sot, respektivisht në vitet 1868, 1999, 2019 dhe 2021, deri te shkarkimi nuk ka ardhur).

9. Presidenti i Kosovës

9.1. Pozita kushtetuese

Duke ndjekur traditat logjike të republikave parlamentare, Presidenti i Republikës në Kosovë shpreh kategorinë **më shumë ceremoniale sesa ekzekutive** të shtetit, që është rrjedhje normale e dizajnit të tij kushtetutes. Dy janë funksionet bazike të shefit të shtetit kosovar: një, kryen detyrën më shumë ceremoniale të kreut të shtetit; dhe, dy, është i veshur me një numër të kompetencave kushtetuese, të cilat, në modelin aktual kushtetues, përcaktojnë vendimmarrje zinxhirore dhe definojnë pozitën e këtij organi kushtetues që është tipike për një sistem të pastër parlamentar. Përmes ushtrimit të këtyre kompetencave, shefi i shtetit në një republikë parlamentare materializon rolin dhe pozitën e vet kushtetuese si përfaqësues i **unitetit juridiko-kushtetues** të shtetit dhe popullit dhe si garantues i funksionimit të institucioneve të sistemit.

Në rolin e tij si kreu i shtetit, Presidenti kryen funksione kryesisht formale, në të cilat parimisht vihet në rolin e konfirmuesit ceremonialë të vendimeve të organeve tjera të shtetit. Si kreu i shtetit, presidenti luan **një rol neutral** përballë jetës politike dhe në parim nuk ndërhyn në çështje të natyrës partiake. Nëse e krahasojmë me ligjet e inxhinierisë mekanike, pushteti neutral dhe i ndërmjetëm i shefit të shtetit në një sistem kushtetues parlamentar luan rolin e një lubrifikanti të makinerisë së pushtetit (makinerisë legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore), me qëllim që kjo makineri të lëvizë në një drejtim të përgjithshëm me qëllim të përbashkët të përcaktuar me kushtetutë. Pa këtë lubrifikant në duart e pushtetit të tretë neutral dhe të ndërmjetëm, me autorizime të qarta balancuese të cilat nuk i kanë asnjëri prej tri pushteteve dhëmbëzoret e makinerisë së tri pushteteve, e thënë kjo në mënyrë figurative, do t'ia thyenin dhëmbët njëri-tjetrit dhe do të bëheshin jofunksionalë dhe pa vlerë, marrë si tërësi. Një gjendje e tillë do të përfundonte ose në centralizim të pushtetit dhe në despotizëm ose në shkapërderdhjen e tij dhe, për pasojë, në një anarki totale. Në këtë kuptim duhet të kuptohen çdo herë kompetencat neutrale dhe të ndërmjetme të secilit president apo monark në një demokraci kushtetuese parlamentare. U mor vesh, kushtetutat bashkëkohore e kanë mjaft të pasur listën e kompetencave të tilla, larg më të pasur dhe më të ndryshme se nga koha kur **Benjamin Konstan** ka shkruar dhe ka vënë themelet për shefin e shtetit

si pushtet neutral dhe i ndërmjetëm.[81] Koncepti teorik dhe praktika e vënies së tij në jetë, megjithatë, ngelen të pandryshuar që nga ajo kohë. Në kuadër të listës së tillë të kompetencave të shefit të shtetit hyjnë kompetencat si iniciativa legjislative dhe kushtetuese, dekretimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve, dekretimi i zyrtarëve të caktuar shtetërorë dhe kështu me radhë. Këto kompetenca janë vendimmarrje zinxhirore, tërësisht në funksion të neutralizimit të njërit prej tri pushteteve, me kapacitet të ndërmjetëm sa i përket natyrës së tyre. Të kësaj natyre janë edhe kompetencat tjera, siç janë dhënia e mandatit për formimin e ekzekutivit dhe shpërndarja e parlamentit pas plotësimit të kushteve të caktuara me kushtetutë (kur të njëjtat organe delegjitimojnë vetveten). Ka edhe shumë kompetenca të tjera që gjenden në menynë e kategorisë së pushtetit neutral dhe të ndërmjetëm. Në këtë grup hyn edhe shpallja e ligjeve dhe e drejta e faljes. Shtjellimet si më sipër të **B. Constant**-it gjetën shprehjen e tyre kushtetuese në dy kushtetutat e para të nxjerra pas rrëzimit të **Napoleon Bonapartes**. E kemi fjalën për kushtetutat e **Brazilit** (1824) dhe të **Portugalisë** (1826). Në dy këto kushtetuta, shefi i shtetit, perandori (Brazil) dhe mbreti (Portugali) respektivisht, u cilësua si kreu i shtetit duke u veshur me pushtet neutral dhe të ndërmjetëm. Qëllimi i kësaj veshje me këtë pushtet ishte që ky shef i ri i shtetit të qëndronte ndaras nga tri pushtetet e tjera me qëllim parësor ruajtjen e institucioneve funksionale dhe stabile.[82]

---

[81] Benjamin Konstan e ka krijuar konceptin për pushtetin e shefit të shtetit si pushtet pasiv ekzekutiv, me disa autorizime neutral dhe të ndërmjetme, që shërbejnë për baraspeshimin e tri pushteteve të tjera. Pse? Ky autor me shef të shtetit e ka nënkuptuar monarkun francez pas rrëzimit të **Napoleon Bonopartes** (Napolon Buonoparte: 1769-1821), i cili, si monark kushtetues, do të kishte pushtet neutral dhe të ndërmjetëm për të korrigjuar dhe neutralizuar tri pushtetet tjera. Mbreti këtë funksion e luan më së miri sepse qëndron jashtë dinamikave të votës së lirë dhe proceseve politike, ka prestigjin e kurorës, reputacionin dhe paanësinë që të gjithë e respektojnë. Mbi këtë bazë është bërë edhe ideja e shefit republikan të shtetit në një sistem parlamentar, ku presidenti i republikës duhet të qëndron mbi palët, duke ushtruar kompetenca zinxhirore që asnjëherë nuk mund të realizohen pa të, por edhe ai nuk mund t'i ushtroj duke injoruar institucionet dhe organet tjera që janë në zinxhirin e mëhershëm të vendimmarrjes së bashku me te. Cf. më shumë në Enver Hasani, *E drejta kushtetuese Studim kritik mbi librin "E drejta kushtetuese"* të au*torëve A. Bajrami e F. Muçaj*, (Jalifat Publishing: Hjuston, Teksas, SHBA, 2018), fq. 218-238.

[82] Debatin pro dhe kundër posedimit të pushteteve neutrale dhe të ndërmjetme të shefit të shtetit, përkatësisht presidentit së republikës, e ka nisur **Karl Shmit** (Carl Schmitt: 1888-1985) me një shkrim të tij polemizues, i njohur si "Ruajtësi i Kushtetutës", për të vazhduar nga **Hans Kelsen**, i cili, në përgjigjen e tij ndaj shkrimit të K. Shmit, në një shkrim të tij me titull "Kush duhet të jetë ruajtës i Kushtetutës?", ka hedhur poshtë në tërësi konceptin shmitian mbi natyrën dhe pozitën e shefit të shtetit. Cila, pra, është esenca e këtij debati në mes të këtyre dy autorëve të njohur? Para se të fillojmë këtë shtjellim, në fillim duhet të konstatojmë se konceptet themelore të këtyre debateve dhe vetë përmbajtja e tyre paraqesin vetë themelet aktuale të natyrës dhe pozitës së presidentit të republikës. Më një fjalë, debati Shmit-Kelzen nuk duhet shikuar si një debat teoriko-historik por si një debat aktual teoriko-praktik, rëndësia e të cilit mbetet krejt e pandryshuar nga koha kur ka lindur.
Siç dihet nga historia e teorisë kushtetuese, debati Shmit - Kelsen është bërë për çështjen se kush është, apo kush duhet të jetë, garant i kushtetutës. Gjatë atij debati fillestar, është hedhur dritë edhe për rolin dhe për rëndësinë e shefit të shtetit (kryesisht) në demokracitë parlamentare me rregullim (kryesisht) republikan. Një pjesë e madhe e atij debati kishte të bënte me shefin e shtetit, si përfaqësues i unitetit të popullit, dhe me mospajtimin konceptual përkitazi me atë nëse ky unitet është sociologjiko-politik, apo nëse ka natyrë ekskluzivisht juridiko-kushtetuese. Të parën pikëpamje e ndërtoi dhe e mbështeti deri në fund Karl Shmit, kurse të dytën – Hans Kelsen.
Koncepti i shefit të shtetit, si përfaqësues i unitetit sociologjiko-politik, te Karl Shmit, është mjaft i strukturuar dhe përfundon në personin e Fyhrerit, i cili gjendet në krye të piramidës shtetërore si mishërim i unitetit të tillë. Te **Hans Kelsen**, po ashtu, koncepti është mjaft i strukturuar, por, në një mënyrë e në një kah tjetër, krejt të kundërt, me atë të **K. Shmit**. Shefi i shtetit, te **H. Kelsen**, del si mishërim i unitetit juridiko-kushtetues të popullit, kurse, në krye të piramidës shtetërore, gjendet norma bazë ("grundnorm"), të cilën shefi i shtetit duhet ta vëjë në jetë krahas me institucionet tjera kushtetuese. Derisa teoria e parë është në esencë diktatoriale, e dyta paraqet të kundërtën e saj. Cf. më shumë në hollësi për këtë debat në: Karl Smit, "Cuvar Ustava". Në Slobodan Samardzic (ed.), *Norma i Odluka. Karl Smit i njegovi kriticari* (Filip Visnjic: Beograd, 2001), fq. 211-253, në fq. 211-238. Titulli i origjinalit: Carl Schmitt, "Der huter der verfasung". *Archiv des offentlichen rechts*, Neue Folge 16 Band J.C.B. Mohr (Paul Siebeck: Tubingen, 1929); Karl Smit, *Tri vrste pravnonaucnog misljenja* (Biblioteka Parerga: Beograd, 2003), fq. 34-42; 46-54, titulli në origjinal: Schmitt, Carl, U*ber die drei Arten des rechtsëissenschaftlichen Denkens*, Hamburg, Hanseatische Verlagsanstalt: Hamburg, 1934); Hans Kelsen, "Ko treba da bude cuvar Ustava ", në Slobodan Samardzic, Slobodan, *Norma i Olduka*, fq. 256-297, në fq. 265, titulli në original: Hans Kelsen, *Wer soll der huter*

As në Kosovë e as në vendet e tjera që kultivojnë demokraci kushtetuese parlamentare, shefi i shtetit (monarku ose presidenti) nuk mund të ketë **asnjë kompetencë ekzekutive autonome**, pra asnjë kompetencë që mund ta ushtrojë në mënyrë të pavarur dhe që i takon kategorisë së pushtetit aktiv. Çdo vendimmarrje e shefit të shtetit në një demokraci kushtetuese parlamentare është zinxhirore dhe ka për qëllim të vetëm neutralizimin e tri pushteteve të tjera dhe garantimin e funksionimit të tyre stabil dhe në pajtim me kushtetutën. Kjo është kështu sepse shefi i shtetit në një demokraci parlamentare nuk bën pjesë në aparatin qeverisës por ka rolin e ruajtësit të institucioneve përmes ushtrimit të autorizimeve neutrale dhe të ndërmjetme.

Dy funksionet si më sipër të presidentit të republikës parlamentare, si kreu i shtetit dhe si ruajtës i unitetit juridiko-kushtetues të popullit dhe shtetit dhe si garantues i funksionimit të institucioneve të sistemit, varen shumë nga përcaktimi specifik kushtetues, sepse secili regjim kushtetues vendos mbi specifikat e kompetencave që bart një president i caktuar. Vështruar në aspektin e modelit kushtetues të presidentit të republikës, variacioni në kompetencat e tij dhe në modelin e zgjedhjes së tij/saj është përcaktor i tipit të presidentit të republikës. Kjo vlen edhe për Kosovën. Neni 83 i **KKos** është përcaktori kushtetues i funksionit bazik të presidentit të republikës. Ky nen përcakton që presidenti është kreu i shtetit dhe që përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës. Janë dy koncepte kushtetuese që duhen komentuar me këtë rast: një, koncepti i presidentit të republikës si kreu i shtetit, dhe dy, koncepti i presidenti si përfaqësues i unitetit të popullit.

Koncepti i presidentit si kreu i shtetit dihet, në tërësi i takon sferës së formës kushtetuese që definon fizionominë e këtij organi kushtetues si një organ që nuk ka ingerenca qeverisëse.[83] Përcaktimi i nenit 83 sipas të cilit është kreu i shtetit, më shumë nënkupton një organ me autoritet ceremonial, formal, sesa një organ me autoritet qeverisës. I vënë në këtë kontekst, neni 83 ilustron pozitën formale të presidentit si kreu i shtetit dhe jo kompetencat apo autoritetin e tij substancial si organ shtetëror. Një veçori tjetër e këtij koncepti është se, si kreu i shtetit, presidenti logjikshëm vishet me autoritetin që të përfaqësojë shtetin në nivelet më të larta të komunikimit të brendshëm dhe ndërkombëtar, thjesht si një detyrë ceremoniale pa asnjë diskrecion në vendimmarrje. Shikuar në këtë perspektivë, në pozitën e kreut të shtetit, presidenti vepron në përputhje me autoritetin kushtetues të institucioneve tjera shtetërore dhe vulos vendimet e tyre thjesht në aspektin ceremonial/formal, nëse nuk është përcaktuar ndryshe në listën konkrete të kompetencave të tij/saj. Për pasojë, funksioni i kreut të shtetit duhet shikuar në përputhje me tërë sistemin kushtetues dhe kompetencat që i janë veshur institucioneve të tjera shtetërore, përderisa ky funksion kushtetues i presidentit të republikës ka më shumë theks ceremonial (formal) sesa theks të një autoriteti substancial. Ky aspekt, por edhe aspekti i presidentit të Republikës së Kosovës si përfaqësues i unitetit të popullit, kanë qenë objekt shqyrtimi dhe vendosjeje në një aktgjykim të **GJKRKS**, në Aktgjykimin për rastet KO.29/12 dhe KO. 48/12, i datës 20 korrik 2012 (Nr. ref. AGJ 284/12). Me këtë aktgjykim, **GJKRKS** ka kryer detyrën e kontrollit abstrakt preventiv të kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese të propozuara nga Kuvendi i Kosovës, më datat 23 mars dhe 4 maj 2012 respektivisht.[84] Në këtë aktgjykim, **GJKRKS** ka dhënë verdiktin e

der verfassung sein?, (Dr. Walther Rothschild: Berlin-GruNewald, 1931).
Me kalimin e kohës, teoria e dytë e **Hans Kelsen**-it u bë vetë thelbi i asaj që tashmë njihet si teoria dhe praktika për demokracinë kushtetuese. Thënë më saktë, teoria e dytë, për dallim nga e para, e cila vuri themelet e arsyetimit irracional të diktaturës naziste, shërbeu si substrakt i teorisë dhe i praktikës së konstitucionalizmit modern që mori hov pas **Luftës së Dytë Botërore**.

83 Përcaktimi që presidenti është kreu i shtetit tregon që ky i fundit natyrshëm udhëheqë (kryeson) por nuk qeverisë. Cf. më shumë në Octavio Amorim Neto & Kaare Strøm, "Breaking the Parliamentary Chain of Delegation: Presidents and Non-Partisan Cabinet Members in European Democracies" *British Journal of Political Science*. Vol. 36 No. 4 (2006), fq. 619-643.

84 **Kontrolli preventiv**, si në rastin e **Kosovës**, është i rrallë dhe ekziston vetëm në disa vende, siç janë **Azerbajxhani**,

saj më gjithëpërfshirës sa i përket rolit dhe pozitës së shefit të shtetit kosovar. Si i tillë, Aktgjykimi prek esencën e debatit **Shmit-Kelsen**, duke lëvizur në pikëpamje praktike në vijat e stërholluara të konstitucionalizmit modern të rrahur nga **Hans Kelsen** dhe të tjerët pas tij. Nga **GJKRKS** u kërkua që të konstitucionalizojë termet e një marrëveshjeje të nënshkruar në mes të forcave politike kosovare më 6 prill 2011, marrëveshje e cila thoshte se shefi kosovar i shtetit duhej të shkonte në shtëpi, pra të shkarkohej, brenda (apo pas) gjashtë (6) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të amendamentit dhjetë (X) të propozuar. Ky amendament, së bashku me mbi 60% të amendamenteve tjera, njëmbëdhjetë (XI) gjithsejtë, u deklarua si në kundërshtim më **KKos**. Mospajtimi me kushtetutën i këtij amendamenti dilte jo vetëm nga cenimi i kapitullit II të Kushtetutës ("Të Drejtat dhe liritë themelore"), por edhe të dispozitave, parimeve dhe vlerave të tjera kushtetuese mbi të cilat qëndron rendi kushtetues kosovar, siç janë parimi i barazisë para ligjit, i sundimit të ligjit dhe i sigurisë juridike, si dhe i mosdiskriminimit. Esenca e këtij verdikti sa i përket rolit dhe rëndësisë së shefit të shtetit në përgjithësi, duke përfshirë këtu sistemin kosovar kushtetues, është kjo: kandidat për **president të Kosovës**, nga forcat politike, në bazë të marrëveshjes së datës 6 prill 2011, u propozua zonja **Atifete Jahjaga**, një oficere në **Policinë e Kosovës**; të njëjtat parti politike që kishin bërë marrëveshje politike si më sipër, nxorën amendamentin kushtetues X, me të cilin përcaktonin që kandidati i tyre i propozuar, që u votua në Kuvend me tetëdhjetë (80) vota pro, aq sa kërkon **KKos** për zgjedhjen e Presidentit të Republikës, duhet të shkoj në shtëpi ani pse kishte dhënë betimin për të shërbyer qytetarët e vendit për pesë (5) vitet në vijim. **GJKRKS** gjeti se ndërprerja e parakohshme e mandatit të shefit të shtetit ishte kundërkushtetuese, sepse cenonte rënd dispozitat e kapitullit të dytë të **KKos**, frymën dhe shpirtin e saj, ngaqë bazohej në vënien në jetë të një marrëveshje politike. Me këtë rast, **GJKRKS** ka konstatuar se qytetarët e vendit kishin pasur pritje legjitime që shefja e shtetit të tyre, që kishte dhënë betimin se do t'u shërbente atyre në atë cilësi për pesë (5), pra jo disa muaj pasi ishte lidhur marrëveshja politike e datës 6 prill 2011, siç mendonin liderët e forcave politike të kohës. Kështu edhe pati ndodhur: znj. **Jahjaga** shërbeu, si gruaja e parë, **Presidente e Kosovës** në mandatin e plotë kushtetues (7 prill 2011-7 prill 2016). Me këtë vendim, **GJKRKS** bëri të qartë se marrëveshjet politike kanë karakter extra kushtetues dhe nuk mund të shërbejnë si parametër për vlerësim të kushtetutshmërisë së akteve dhe veprimeve juridike të organeve publike në Kosovë.[85]

Në kryerjen e detyrës së tij/saj si kreu i shtetit, presidenti, sipas nenit 83 të **KKos**, duhet të veprojë në linjë me të mirën publike të tërë shtetit dhe jashtë çdo linje të ngushtë partiake apo personale. Funksioni i kreut të shtetit, prandaj, është funksion që kërkon integritet neutral dhe përmbajtje meritore, meqë materializimi i vendimeve në kuadër të këtij funksioni duhet të përfaqësoj të mirën publike/shtetërore para interesave elektorale/partiake. Në këtë kontekst, në kryerjen e funksionit të kreut të shtetit, sipas këtij neni, presidenti duhet përmbajtur këtyre katër parimeve: a) shprehjes së neutralitetit: në kryerjen e detyrës së tij si kreu i shtetit, Presidenti nuk lejohet që të marrë veprime që lejojnë hapësirë për anim partiak, politik apo personal; b) kredibilitetit shtetëror: në kryerjen e këtij funksioni, Presidenti përfaqëson shtetin dhe jo interesin e tij/saj personal apo partiak, prandaj publiku duhet të jetë i bindur arsyeshëm që veprimet në kuadër të

Kirgizia, **Moldavia**, **Turqia** dhe **Ukraina**. Kontrolli i tillë abstrakt preventiv mbi amendamentet kushtetuese e vendos **KKKos** jo thjesht në pozicion të një **legjvënësi negativ**, por edhe të një **kushtetutëbërësi negativ**, meqë amendamentet e tilla kushtetuese i nënshtrohen kontrollit kushtetues sa i përket të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me kushtetutë. Në këtë perspektivë, ky kontroll i tipit preventiv vetëm se e fuqizon edhe më tutje karakterin e ngurtë të Kushtetutës së Kosovës, duke mundësuar që gjyqësia kushtetuese të ketë funksion themelor në qeverisjen e shtetit. Cf. analizën komparative të Komisionit të Venedikut: Report on Constitutional Amendment, No. 469/2008, adopted by the Venice Commission at its Plenary Session, CDL-AD (2010) 001, Starsbourg, 19 January 2010 Venice, 11-12 December 2009. Në internet mund të gjendet në: www.venice.coe.int, me këtë shenjë: CDL-AD (2010) 001. Për aspektet teorike të kontrollit preventiv të amendamenteve kushtetuese, Cf. Kemal Gozler, "Judicial review of Constitutional Amendmenets. A Comparative Study (Bursa: EKIN PRESS: Bursa, 2008); Jeffery Gray Jacobsohn, Jeffrey Gary, "An unconstitutional constitution? A comparative perspective'. *International Journal of Counstitutional Law*. Vol. 4 No. 3 (2006) fq. 460-487.

[85] **Rastet KO. 29/12** dhe **KO. 48/12**. *Aktgjykim. Amendamentet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars dhe 4 maj 2012.* Datë 20 korrik 2012. Prishtinë. Nr. ref.: AGJ 284/12.

këtij funksioni janë thjesht në përputhje me interesat e gjëra shtetërore, si në kuadrin e brendshëm ashtu edhe në atë të jashtëm; c) objektivitetit: në kryerjen e këtij funksioni, Presidenti duhet të gjykoj objektivisht nga pritjet e publikut të gjerë sa i përket përfaqësimit të interesit shtetëror, dhe të veproj në mënyrë të tillë që pritjet e publikut për veprimet e kryera në kuadrin e këtij funksioni të mos lënë dyshim për anime personale të Presidentit të Republikës;[86] dhe, d) kufizimi i këtij funksioni në aspekte formale: përcaktimi i vënë në nenin 83 të **KKOs** për Presidentin e Republikës si kreu i shtetit duhet interpretuar në mënyrë të ngushtë, duke përjashtuar çdo hapësirë që kjo të nënkuptojë një autoritet substancial të qeverisjes në dobi të Presidentit të Republikës. Në kryerjen e këtij funksioni, Presidenti është i kufizuar me kompetencat e institucioneve tjera, dhe natyrshëm, materializimi i këtij funksioni, siç është e pritshme nga këndi i standardeve ndërkombëtare, nuk mund të ngërthej në vete pushtim të kompetencave substanciale të institucioneve të tjera të vëna me **KKos**.

Në kuptim të nenit 83 të KKos, Presidenti përcaktohet edhe si përfaqësues i unitetit të popullit të Republikës së Kosovës. Ky koncept duhet vështruar me shumë kujdes, meqë përfaqëson një nga parimet më të rëndësishme të tërë KKos, në kontekst të së cilës duhet shpjeguar tërë dizajni institucional i shtetit dhe raporti mes institucioneve. Në dimensionimin e Presidentit të Republikës si përfaqësues i unitetit të popullit, rol të rëndësishëm kanë luajtur aktgjykimi në rastin **Rrustemi et al v. Presidenti i Republikës**[87] i datës 28 shtator 2010 dhe ai i sipërcekur lidhur me rastin Jahjaga, përkatësisht aktgjykimi për **rastet KO.29/12** dhe **KO. 48/12**. Në vijim të kësaj, koncepti shefit të shtetit si përfaqësues i unitetit posedon, të paktën, dy cilësi. Së pari, në kuptim të nenit 83 të **KKos**, përfaqësimi i unitetit të popullit gjen shtrirje shumë më të gjerë, sesa thjesht në kuptimin formal. Në aspektin e multietnicitetit, si parim bazik i proklamuar me kushtetutë, koncepti i një presidenti që përfaqëson unitetin e popullit duhet shpjeguar në kontekst të **demokracisë konsociacionale**.[88] Kjo nënkupton që, detyrimi që lind nga neni 83 **KKos** është që presidenti të jetë përfaqësues jo thjesht i unitetit të shumicës, por përfaqësues i unitetit të tërë popullit, duke marrë parasysh edhe vullnetin e komuniteteve pakicë. Në këtë aspekt, përfaqësimi i unitetit të popullit në kuptim të këtij neni duhet të përmbush kushtet e një uniteti popullor multietnik jo thjesht në kuptimin subjektiv, por edhe në kuptimin objektiv. Nuk mjafton që presidenti të jetë një përfaqësues i unitetit të popullit në aspektin e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë, por edhe të shihet objektivisht si i tillë nga të gjitha komunitetet etnike. Kjo nënkupton që përfaqësimi i unitetit të popullit nga ana e Presidentit të Republikës duhet të jetë një funksion mbietnik, që i shërben konceptit të shtetit neutral ndaj etnisë.[89] Së dyti, në kuptim të nenit në fjalë,

---

86 Kjo vlen edhe për ushtruesin e detyrës së presidentit, i cili po ashtu duhet t'i ushtroj kompetencat e presidentit në mënyrë të njëjtë sikur Presidenti i Republikës. Se kjo është kështu është parë nga pyetjet që iu patën drejtuar Dr. **Jakup Krasniqit**, kryetar i Kuvendit të Kosovës (2007-2014), për sjelljet e tij në kohën sa ka qenë duke ushtruar detyrën e Presidentit të Republikës (shtator 2010-prill 2011), për shkak se kishte refuzuar emërimin e disa gjyqtarëve dhe kishte dhënë falje e ndarë dekorata të cilat në publik u patën parë si sjellje arbitrare dhe jobjektive. Cf. Kuvendi i Republikës së Kosovës. Lajmet e fundit: Reagim i Kabinetit të Kryetarit të Kuvendit, 20 shkurt 2012, e hënë, ueb-faqja e **Kuvendit të Kosovës**: http://www.kuvendiKosovës.org/?cid=1,128,4462 (shikuar më 24 nëntor 2012); "Eliminuan nga lista Driton Muharremin", gazeta e përditshme "Kosova sot", 27 janar 2012, e premte, version elektronik vetëm (http://www.kosova-sot.info/politike/Kosovë /eliminuan-nga-lista-dritonmuharremin). Këtu, në këtë shkrim, analizohet raporti kritik i **Misionit të OSBE**-së në **Kosovë**, i cili flet për parregullsitë në emërimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve të Kosovës nga u.d. i Presidentit, Dr. **Jakup Krasniqi**), si dhe për rastet e faljeve të dhëna e dhuratave të ndara.

87 *Aktgjykim: Rasti nr. KI 47/10, "Naim Rrustemi dhe 31 deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kundër Shkëlqesisë së tij, Fatmir Sejdiu, President i Republikës së Kosovës",* Nr. ref.: AGJ 43/10. Datë 28 shtator 2010.

88 Cf. fusnotat 64-67 dhe 69-71, **supra**, në këtë pjesë, si dhe teksti që i shoqëron.

89 Ky segment është elaboruar me elokuencë nga **GJKRKS** në rastin e sipërcekur të ish-Presidentes **Jahjaga**, ku është vendosur në mënyrë abstrakte dhe preventive mbi kushtetutshmërinë e amendamenteve kushtetuese të propozuara. Me këtë rast Gjykata ka theksuar se nuk është vetëm Kapitulli II i **KKos** standard për referim, por edhe Kapitulli III ("Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjestarëve të tyre"), si dhe tërë fryma e **KKos**. Mbi bazën e këtij standardi, GKKos ka vlerësuar edhe rolin dhe pozitën e shefit kosovar të shtetit i cili, gjithnjë sipas **GJKRKS**, ka detyrim kushtetues të përfaqësoj unitetin juridik-kushtetues të popullit, jo unitetin sociologjiko-politik të tij. Me këtë qasje, **GJKRKS** ka përqafuar **doktrinën gjermane** mbi kushtetutën si një tërësi organike e cila përmban norma, parime dhe vlera të cilat vetëm si një tërësi mund të japin kuptimin dhe thelbin e tërësishëm të konstitutcionalizmit modern. Cf. më shumë në Donald P. Kommers, "German Constitutionalism: A Prolegomenon".

përfaqësimi i unitetit të popullit duhet shikuar edhe në kontekst të një konsensusi të gjerë partiak e politik mbi rolin e presidentit dhe kryerjen e funksionit të tij.

Dy cilësitë si më sipër janë shtjelluar në rastin **Rrustemi et al v. Presidenti i Republikës**, ku është sqaruar se funksioni i Presidentit të Republikës si përfaqësues i unitetit të popullit ka tri kuptime: a) që Presidenti të mos jetë pjesë aktive e ndonjë partie politike, apo që të mos mbaj çfarëdo posti që mund t'ia paragjykojë animin e tij partiak/politik. Kjo nënkupton që përderisa është në detyrën e tij kushtetuese, Presidenti nuk mundet të mbaj apo të ushtroj çfarëdo detyre partiake, pavarësisht nëse ajo bëhet në mënyrë formale apo substanciale. Në kuptim të rastit në fjalë, Presidenti i Republikës nuk lejohet qoftë edhe ceremonialisht apo formalisht të mbaj çfarëdo titulli apo pozite partiake, dhe që fakti më i vogël, qoftë edhe formal, që racionalisht e lidh presidentin me mbajtjen apo ushtrimin e një detyre partiake shkel përcaktimin e vënë në nenin 83 të KKos që ajo/ai të përfaqësoj unitetin e popullit; b) që Presidenti të mos jetë pjesë qoftë edhe pasive e ndonjë strukture, rryme apo lëvizjeje me karakter partiak: Presidenti, për aq kohë sa është i detyruar të përfaqësojë unitetin e popullit, nuk lejohet që t'i përkas as pasivisht një partie politike. Kjo nënkupton që Presidenti nuk lejohet që të shihet nga të tjerët në një pozicion pasiv kur atij/asaj i adresohen anime partiake, apo kur asaj/atij, nga një pritje e arsyeshme, publiku e gjen pasiv përballë animeve që interpretohet si të atribuara ndaj një partie politike apo një grupimi politik; c) Presidenti, në mënyrë që të ushtroj detyrën e një përfaqësuesi të unitetit të popullit, duhet që të mos jetë thjesht vetëm në pikëpamje subjektive i paanshëm ndaj cilësdo parti politike, por edhe që të shihet ashtu në anën e jashtme.[90] Pra, përfaqësimi i unitetit të popullit duhet të reflektohet edhe objektivisht nga ana e Presidentit të Republikës, në kuptimin që ushtrimi i funksionit të tij duhet të jetë, pritshëm, i shikuar nga ana e publikut si i paanshëm ndaj cilësdo rrymë politike. Ana objektive e paanshmërisë partiake të Presidentit, megjithatë, duhet interpretuar nga këndi i pritjes së arsyeshme, që nënkupton që dyshimi në animin e tij/saj partiak nuk është i mjaftueshëm që publiku ta paragjykoj shkeljen e parimit të përfaqësimit të unitetit të popullit: prandaj, arsyeja mbi animin e tij/saj duhet të jetë e faktuar. Për të qenë objektivisht i pranuar nga publiku si një autoritet i paanshëm ndaj skenës apo rrymave politike, në mënyrë që të përfaqësoj unitetin e popullit, pyetja është nëse Presidenti duhet që të mos ketë qenë pjesë aktive apo pasive e ndonjë partie politike përpara se të vihej në detyrën e presidentit? Megjithëse kjo është një pyetje shumë e ngushtë, është logjikisht e pritshme që koncepti i presidentit si përfaqësues i unitetit të popullit të gjej zbatim prej momentit kur presidenti merr detyrën e tij.

Koncepti i përfaqësimit të unitetit të popullit lind detyrën që Presidenti të jetë kundërbalancues popullor ndaj politikave publike që nxjerr Qeveria dhe Kuvendi. Në këtë rol, Presidenti është i detyruar që të shpreh qëndrimin unifikues popullor përballë politikave publike të institucioneve tjera, duke i kundërbalancuar ato me një qëndrim unifikues popullor. Megjithëse roli i presidentit është relativisht formal, është e pritshme që koncepti që ai/ajo është përfaqësues i unitetit të popullit të shfrytëzohet vetëm në rastet e politikave publike shumë të rëndësishme ku objektivisht publiku i gjerë pret që presidenti të reagojë duke kundërshtuar apo përkrahur një linjë të caktuar politikash publike me referim tek përfaqësimi i unitetit të popullit.

Në përgjithësi, koncepti i funksionit të presidentit si përfaqësues i unitetit të popullit duhet të përbëjë parimin themelor që përcakton funksionin e Presidentit të Republikës, parim i cili duhet të ushtrohet nga ana e Presidentit të Republikës aktivisht dhe objektivisht si i tillë nga publiku i gjerë. Në këtë rol Presidenti duhet shfaqet si një figurë mbipartiake dhe mbietnike, të përfaqësoj dhe avancoj interesin e përgjithshëm popullor dhe shtetëror. Të gjitha **kompetencat që Presidenti i ka të listuara në KKos**, duhet shikuar nën dritën e

Emory Law Journal, Vol. 40, No. 1 (1991), fq. 837-873; Donald P. Kommers. "The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany. Second Edition' (Durham and London: Duke University Press: Durham and London, 1997), fq. 3-60; Cf. Cf. gjithashtu edhe: **Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë (GJKGje)**, në rastin BVerfGE 7, 198 - Lüth (Bundesverfassungsgericht), Urteil, datë 15 janar 1958, në të cilën jepet kjo logjikë e definimit të konceptit kushtetues sipas parametrave të mësipërm.

[90] Presidenti **Fatmir Sejdiu** gjatë tërë kohës sa ka qenë në detyrë ka mbajtur dy pozitat, atë të shefit të shtetit dhe të shefit të partisë, Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Për këtë arsye **GJKRKS** pati gjetur se ai po bënte shkelje serioze kushtetuese. Cf. Aktgjykim: **Rasti Nr. KI 47/10**, paragrafët 65-70.

këtij parimi: ato janë nga e para deri te e fundit të **një natyre joekzekutive**, që shprehin aspektin e **një pushteti neutral dhe të ndërmjetëm**, që ka për detyrë **balancimin dhe neutralizimin e tri pushteteve** të tjera (legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit), në mënyrë që asnjëri prej tyre mos të jetë në gjendje të uzurpoj autorizimet e tjetrit apo të mbivihet mbi tjetrin. Vetë pozita e Presidentit të Republikës, për pasojë, nuk është pjesë e asnjërit prej tri pushteteve, – legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit - të cilat në ushtrimin kushtetues të autorizimeve të tyre varen nga pëlqimi kushtetues i tij. Ushtrimi i kompetencave të Presidentit të Republikës bën që uniteti i popullit, si një kategori sociologjiko-politike dhe abstrakte, të shndërrohet në një **unitet konkret juridiko-kushtetues**: populli dhe shteti gjejnë shprehjen e tyre gjatë materializimit të kompetencave të Presidentit të Republikës, materializim që i shërben garantimit dhe sigurisë së funksionimit normal të institucioneve të sistemit kushtetues dhe barazisë e lirisë së të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe atyre që bien nën juridiksionin e autoriteteve të Republikës së Kosovës.

9.2. Kompetencat

Neni 84 i **KKos** përcakton kompetencat specifike të Presidentit të Republikës. Ato, kryesisht, gjenden në atë nen.[91] Disa prej tyre, megjithatë, përcaktohen edhe me disa nene të tjera të **KKos,** por edhe mund të rrjedhin nga parimet e përgjithshme të nenit 83 lidhur me nenin e 4.3 të **KKos**. Ky i fundit përcakton se "Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë". Sikundër shihet, redaktimi i kësaj dispozite, që normon parimin themelor të formës së qeverisjes dhe ndarjes së pushtetit dhe i takon dispozitave themelore, është më i gjerë e më gjithëpërfshirës se dispozita e formuluar në një fjali të vetme në nenin 83, që normon statusin e Presidentit të Republikës, në të cilën thuhet si vijon: "Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikë së Kosovës".

Vlen të theksohet se interpretimi i nenit 84 të **KKos** nënkupton një **ndalesë të rreptë** për caktimin e kompetencave shtesë për presidentin përmes ligjeve të Kuvendit të Kosovës. Kjo bëhet e qartë nëse më në detaje shikohet secila kompetencë e Presidentit të Republikës, të dhëna me nenin 84 të **KKos**: formulimi i tyre, pa asnjë dyshim, tregon se ligji apo akti tjetër juridik, përfshirë marrëveshjet ndërkombëtare, nuk mund të shërbejnë si bazë juridike për kompetenca shtesë për Presidentin e Republikës. Në praktikën e **GJKRKS**, megjithatë, një kohë (2009-2015), u pat ndërtuar një autorizim i Presidentit të Republikës për referim të çështjeve në **GJKRKS**, jashtë kontekstit të nenit 113.2 (1 dhe 2) të **KKos**, kontekst që presupozon ekzistimin paraprak të një **rasti** ose **mosmarrëveshjeje**, si një prezumim i rëndësishëm procedural për pranueshmërinë e kërkesës për gjykim dhe vendosje meritore. Kjo praktikë është braktisur nga **GJKRKS**, duke kufizuar autorizimin e presidentit të vendit për referim të çështjeve vetëm në rastet kur ekziston një rast ose mosmarrëveshje në kuptim të nenit 113.2 (paragrafët 1 dhe 2) të **KKos**.[92] Përkundër faktit që lidhja e autorizimit të presidentit për ngritje të çështjeve kushtetuese në **GJKRKS** me ekzistimin e një rasti ose mosmarrëveshjeje kushtetuese ka qenë i qëlluar, arsyetimi për braktisje të standardit të vjetër, megjithatë, ka qenë pa vend dhe ka pasur të meta serioze formale dhe

---

91 Si shembull interpretues, **Gjykata Kushtetuese e Ukrainës** në vendimin e saj, Vendimi Nr. 3-rp/2008, ka theksuar se, kompetencat e presidentit të Ukrainës janë të përcaktuara taksativisht me kushtetutë, gjë që e bën të pamundur miratimin e ndonjë ligji që mund të shtojë të drejta apo detyrime të tjera në mënyrën e kompetencave kushtetuese për presidentin. Cf. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Ukrainës, Nr. 3-rp/2008, i dates 01.04.2008.

92 Si rast i fundit në praktikën e Gjykatës që është vendosur meritorisht mbi bazën e këtij formulimi kushtetues ka qenë rasti i **Asociacionit Serb**, i cili ishte ngritur nga ish-Presidentja e Kosovës, znj. **Atifete Jahjaga.** Cf. **Rasti KO 130/15**. *AKTGJYKIM. Parashtrues. Presidentja e Republikes se Kosovës, Lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë -Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore" me fryrnën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,* Prishtine: 23 dhjetor 2015. Nr. ref.:AGJ877/15.

përmbajtësore.[93] Sa i përket formës, vlen të thuhet se është fakt notor që ndryshimi i një precedenti të vendosur me vendim meritor nuk mund të bëhet asnjëherë me vendim jomeritor. Nuk mund të ketë as vendosje të precedentit përmes vendimeve jomeritore për faktin se këto lloje të vendimeve nuk prekin objektin e çështjes, por merren vetëm me vlerësimin nëse objekti i kontrollit kushtetues është i përshtatshëm për t'u gjykuar dhe vendosur në aspektin material (**ratione materiae**), kohor (**ratione temporis**), vendor (**ratione loci**) dhe sa i përket palëve (**ratione personae**). Sa i përket përmbajtjes së arsyetimit, ndërkaq, gjendja paraqitet edhe më e rënd në defekte. Si pikë nisëse e premisës themelore të vendimit të **GJKRKS** për të deklaruar kërkesën si të papranueshme ka shërbyer një **argument konspirativ**, sepse ka konstatuar, pa asnjë bazë faktike, se gjyqësia kushtetuese kosovare e ndërtuar nga gjyqtarët e përbërjes së parë të **GJKRKS** (2009-2015) e ka kuptuar termin "çështje kushtetuese" në një kuptim të gjerë. Cili është ky kuptim i gjerë i kësaj gjenerate, **GJKRKS** nuk treguar: në arsyetimin e vendimit në fjalë ekziston vetëm një konstatim tjetër konspirativ, që thotë se ai kuptim i gjyqtarëve të gjeneratës së parë"[...] duhet kuptuar në frymën e procesit te vendosjes se themeleve te gjyqësisë kushtetuese, si dhe të nevojës shoqërore që Gjykata në fillesat e saj të përfshihet në interpretime të neneve specifike të Kushtetutës […]". Ky konstatim nuk është aspak i vërtetë dhe mund të vërtetohet me lehtësi nëse lexohen transkriptet e diskutimeve të gjyqtarëve kushtetues të asaj kohe, të cilat gjenden në arkivat e **GJKRKS**, ku qartë shihet se një pjesë jo e vogël e gjyqtarëve të përbërjes së parë, kur është ndeshur me vendimin e parë të kësaj natyre në rastin **Qeska**,[94] ka besuar fuqishëm se redaktimi i dispozitave kushtetuese të nenit 84.9 dhe 93.10 të Kushtetutës nuk lënë asnjë hapësirë për dyshim se mesazhi i tyre bën fjalë për një kompetencë dhe tagër për vënien në lëvizje të **GJKRKS** vetëm brenda juridiksionit nga neni 113 i **KKos**. Këtë besim gjyqtarët e kohës e kanë mbështetur në redaktimin e dispozitës së nenit 113.10 të Kushtetutës, që thotë se juridiksioni shtesë mund të caktohet edhe me ligj. Në të njëjtën kohë, ka pasur gjyqtarë të tjetër, përfshirë edhe autorin e parë të këtij libri, që kanë dhënë argumentim të kundërt, bazuar në redaktimin e dispozitave të ngjashme lidhur me palët e tjera të autorizuara që gjenden jashtë nenit 113 të KKos, që modelohen në zgjidhjet e jashtme kushtetuese.[95] Argumenti themelor i gjyqtarëve të përbërjes së parë të **GJKRKS** është bazuar në autorizimet e avokatit të popullit, si palë e privilegjuar, që gjenden në dispozitën e nenit 135.4 ["Raportimi i Avokatit të Populit"] të **KKos**, ku përcaktohet se "[...] Avokati i Popullit ka të drejtë të referoj çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute". Kjo nënkupton që, sikur të kishte qenë synim i kushtetutëbërësit kosovar njohja e një juridiksioni shtesë Presidentit dhe Qeverisë, atëherë ai do të kishte bërë një redaktim të njëjtë me dispozitën për avokatin e popullit. Këtë e vërtetojnë edhe zgjidhjet kushtetuese krahasimore, një pjese bukur të madhe e të cilave përcaktojnë se organi përkatës kushtetues ka të drejtën e vënies në lëvizje të gjykatës nacionale kushtetuese në pajtim me përcaktimet në kushtetutën e vendit. Kjo nënkupton se, fjalia si më sipër në nenin 135.4 të **KKos**, që thotë se Avokati i Popullit ka të drejt të referoj çështje kushtetuese vetëm "në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute", ka rrënjët e saj në përvojat dhe zgjidhjet kushtetuese krahasimore.

Paragrafi i parë të nenit 84 të KKos përcakton që Presidenti përfaqëson Republikën e Kosovës brenda dhe jashtë. Mbetet për t'u testuar në praktikë domethënia specifike e kësaj kompetence, sidomos sa i përket përfaqësimit të brendshëm. Në kuptimin e përgjithshëm, ky paragraf i jep presidentit funksionin e përfaqësimit të jashtëm të shtetit, duke nënkuptuar që Presidenti është përfaqësuesi më i lartë i shtetit

---

93 **GJKRKS** ka ndjekur një kurs tjetër në rastin e njohur si rasti KQZ, i ngritur nga Presidenti i Republikës dhe ka vendosur ta ndërpres këtë praktikë: tani e tutje u tha se vetëm dispozitat e nenit 113 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] mund të jenë të vlefshme për të vënë/ lidhur juridiksionin e saj. Cf. **Rasti KO 79/18**. *Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Presidenti i Republikës së Kosovës. Kërkesë për interpretim të nenit 139 paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës*. Nr. rcf.: RK 1294/ 18. Prishtinë, 3 dhjetor 2018.

94 **Rasti KO 80/10**. *Aktgjykim. Kërkesa e Presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së tij, Dr. Fatmir Sejdiu, për sqarim të kompetencave ne rastin e kryetarit te Rahovecit, z. Qazim Qeska*. Ref. nr. AGJ 46110. Prishtine, me 7 Tetor 2010.

95 Këto pikëpamje janë shprehur që në vitin 2013, në komentarin e **KKos**. Cf. Enver Hasani dhe Ivan Cukalovic, *Komentar. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.* Botimi parë (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH: Prishtinë, 2013), fq. 400-402 dhe fq. 444-445.

në botën e jashtme. Koncepti i përfaqësimit të shtetit në botën e jashtme është thjesht një kompetencë formale, pa substancë diskrecioni në vendimmarrje, në paraqitje të qëndrimeve të cilat presidenti duhet t'i përfaqësoj apo edhe në negocim të marrëdhënieve të shtetit me shtetet e huaja. Përfaqësimi jashtë dhe brenda shtetit, si një kompetencë e Presidentit të Republikës, nuk duhet të nënkuptohet si një kompetencë për të krijuar pozicion të cilin Kosova duhet ta mbaj në marrëdhënien e saj me botën e jashtme. Këtu, roli i Presidenti të Republikës është më shumë formal. Kjo, pra, nënkupton që ajo/ai materializon qëndrimin/ vendimin mbi substancën e një marrëdhënieje të jashtme thjesht në nivel të përfaqësimit të shtetit, substancë që definohet dhe përcaktohet nga organet tjera të shtetit, në veçanti nga organi përfaqësues i sovranit të popullit – **Kuvendi i Kosovës**.

Paragrafi i dytë i nenit 84 të **KKos** e veshë Presidentin e Republikës me kompetencën e garantimit të funksionimit kushtetues të institucioneve të përcaktuara me kushtetutë. Kjo kompetencë, në një interpretim tekstual, duket sikur ka një natyrë substanciale që autorizon presidentin për ndërmarrje të veprimeve autonome për vënien në jetë të saj. Në kuptim të veprimeve që mund të ushtrojë Presidenti, për materializm të kësaj kompetence, megjithatë, asnjëherë nuk nënkuptojnë që ajo/ai është gardiani më i lartë i **KKos**. Ky është një funksion që kushtetutëbërësi kosovar ia ka veshur **GJKRKS**. Në kuptim të këtij paragrafi, **KKos** i jep kompetencën Presidentit për të garantuar funksionimin kushtetues të institucioneve në kuadër të materializimit të kompetencave presidenciale. Në këtë aspekt, ky paragraf nuk mëton të jep ndonjë kompetencë shtesë për Presidentin e Republikës, por vetëm të vendos detyrimin që Presidenti ka për të garantuar funksionimin kushtetues të institucioneve në kuadër të kompetencave të tij specifike nga neni 84. Kjo do të thotë se Presidenti nuk mund të shndërrohet në një mbrojtës të jetës institucionale kushtetuese. Për pasojë, ajo/ai nuk mund të marrë për vete prerogativa në bazë të përcaktimit të saj/tij si garantues i funksionimit kushtetues të institucioneve të sistemit. Presidenti nuk mund të mbjell praktika të kontrollit të institucioneve të tjera shtetërore duke u bazuar në këtë autorizim formal për të garantuar funksionimin kushtetues të institucioneve kushtetuese. Kjo është kështu sepse ky paragraf e veshë Presidentin e Republikës me rolin e një kundërbalancuesi të vetëm kushtetues të institucioneve të tjera shtetërore, gjë që nënkupton se materializimi i këtij funksioni nga ana e Presidenti të Republikës nuk mund të prek kufijtë e pavarësisë së institucioneve/pushteteve të ndara, balancues i të cilave është. Këtë funksion e materializon duke **ushtruar autorizimet e tij neutrale** dhe të **ndërmjetme**, përmes dhënies së pëlqimit të fundit kushtetues, duke qenë fjala e fundit kushtetuese gjatë vendimmarrjes zinxhirore, në procesin e formimit të organeve qendrore të përcaktuara me KKos, siç janë: GJKRKS, **GJSKos**, Prokuroria e Shtetit, Agjencia Kosovare e Inteligjencës (AKI), Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), shefat e misioneve diplomatike etj. Në këtë kuptim, presidenti paraqitet si garantues i funksionimit të institucioneve kushtetuese, jo i vetë KKos në kuadrin e sistemit të tërësishëm të ndarjes së pushteteve: funksioni i garantuesit të funksionimit të institucioneve kushtetuese e bën presidentin pikën kyçe në realizmin e doktrinës së ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre.[96]

Paragrafi i tretë i nenit 84 përcakton rolin formal që ka Presidenti i Republikës për të shpallur zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës. Kjo është një kompetencë formale e Presidentit të Republikës, që ushtrohet në bazë të funksionit të saj/tij/ ceremonial si kreu i shtetit. Në ushtrimin e kësaj kompetence, Presidenti nuk gëzon diskrecion vendosjeje, meqë vendimi për të shpallur zgjedhjet është i paralidhur me disa kushte të tjera. Në këtë aspekt, kjo kompetencë nuk ka asnjë ngjashmëri (dhe nuk duhet kuptuar lidhur) me të drejtën e presidentit për të shpërndarë parlamentin nga neni 82.2 i KKos. Për të materializuar shpalljen e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës, Presidenti është i lidhur ngushtësisht me përmbushjen apo krijimin katër kushteve ose situatave alternative:

- që Kuvendi të ketë kaluar një mocion mosbesimi ndaj Qeverisë së Kosovës (neni 82 i **KKos**);

[96] **Rastet KO 29/12** dhe **KO 48/12**, parag. 257-258.

- që Kuvendi, sipas përcaktimit kushtetues, të ketë vendosur për shpërndarjen e vetvetes (neni 81.2 i **KKos**);
- që Kuvendi të ketë dështuar në formimin e Qeverisë dhe zgjedhjen e Presidentit të Republikës, përkatësisht që shpërndarja e Kuvendit të ketë ndodhur **ipso iure**; dhe
- që të ketë përfunduar mandati i rregullt kushtetues i Kuvendit, që nënkupton lindjen e detyrimit për shpalljen e zgjedhjeve të reja (neni 66.1 dhe 2 i **KKos**).

Sikundër vërehet, kompetenca e Presidentit të Republikës për të shpallur zgjedhjet e Kuvendit është e lidhur për rrethanat e caktuara që duhet të paraqiten: Presidenti nuk ka diskrecion në shpalljen e zgjedhjeve sipas dëshirës së saj/tij, sepse ajo çështje është një rrjedhë logjike e një procesi kushtetues, ku hallka e fundit, pra Presidenti, duhet që ta bëjë vetëm shpalljen formale të mbajtjes së tyre. Përveç shpalljes së zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës, Presidenti ka kompetencë të thërras mbledhjen e parë të tij. Edhe kjo është një kompetencë ceremoniale, të cilën presidenti e ushtron në formën e një detyrimi që të thërras mbledhjen e parë të Kuvendit, pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve nga ana e institucioneve përgjegjëse. Edhe kjo kompetencë ushtrohet nga ana e Presidentit të Republikës në kuadër të funksionit të tij ceremonial si kreu i shtetit dhe nuk nënkupton që presidenti të vendos mbi këtë çështje sipas dëshirës së vet. Shkurt, as në ushtrimin e kësaj kompetence, presidenti nuk disponon me diskrecion.

Paragrafi i katërt i nenit 84 të **KKos** përcakton kompetencën e Presidenti të Republikës për të nxjerr dekrete për materializimin e funksionit të vet kushtetues – dekretimin e akteve juridike dhe veprimeve të të tjerëve. Kjo kompetencë e Presidentit të Republikës duhet shikuar në kontekst të materializimit të kompetencave të veçanta të presidentit, që nënkupton se Presidenti i materializon funksionin e tij kushtetues përmes nxjerrjes dhe dekretimit të akteve juridike dhe veprimeve të ndërmarra nga organet tjera kushtetuese. Dekretet, në kuptim të këtij paragrafi, përfaqësojnë akte juridike individuale që e zbatojnë një kompetencë të caktuar të presidentit, duke aplikuar normën e përgjithshme mbi një rast individual. Materializimi i funksioneve të Presidentit të Republikës, në kuptim të këtij paragrafi, bëhet duke lëshuar dekrete, procedurë e cila e zbaton mbi një rast individual një kompetencë abstrakte të Presidentit të Republikës, siç janë: dekretimi i ligjeve, ambasadorëve, gjyqtarëve kushtetues, shefit të AKI-së, KQZ-së dhe kështu me radhë. Në njëfarë mënyrë, thënë me gjuhën laike, dekretimi përfaqëson bekimin e dhënë nga shefi i shtetit për vendimmarrjet që janë kryer gjetiu nëpër procedurat e organeve të tjera kushtetuese, me të cilin kreu i shtetit afirmon kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e ndjekur para atyre organeve.

Paragrafët 5 dhe 6 të nenit 84 të **KKos** nuk bëjnë pjesë në kuadër të të ashtuquajturës kompetencë legjislative të Presidentit të Republikës nga neni 79 i Kushtetutës. Këta dy paragrafë e veshin Presidentin e Republikës me disa garancione kushtetuese të cilat mundësojnë kundërbalancimin e thjeshtë të pushtetit legjislativ. Të dyja, për pasojë, përfaqësojnë kompetenca të ndara të Presidentit të Republikës, të cilat kanë rol të njëjtë. Sa i përket kompetencës së shpalljes së ligjeve të miratuara në Kuvend, ajo është një kompetencë formale e Presidentit të Republikës të cilën e ushtron në kuptim të funksionit të tij kushtetues si kreu i shtetit: shpallja e ligjeve nga ana e Presidenti të Republikës, si një kompetencë kushtetuese, është thjesht e natyrës formale, por pa të cilën ligji nuk konsiderohet ligj. Kjo nënkupton që Presidenti i Republikës nuk mund të refuzoj të shpall një ligj, nëse ai është miratuar siç duhet nga aspekti juridik.[97] Presidenti, megjithatë, të drejtën për kontroll kushtetues të një ligji e ushtron sipas paragrafit 6 të nenit 84 të KKos: nëse ajo/ai nuk e ka ushtruar të drejtën e kthimit të ligjit sipas paragrafit 6, ose nëse ligji rikthyer është rrëzuar me një votim të serishëm në Kuvend, atëherë presidenti është i detyruar ta shpall ligjin e tillë. As këtu Presidenti nuk

[97] Si shembull krahasues, **Tribunali Kushtetues i Polonisë** në rastin K 37/05 ka theksuar se publikimi i një ligji është parakusht për hyrjen në fuqi të tij. Rrjedhimisht, një akt normativ nuk paraqet burim të së drejtës së obligueshme brenda kuptimit të dispozitave kushtetuese derisa të shpallet ashtu siç parashihet me dispozitat kushtetuese. Cf. **Vendimi i Tribunalit Kushtetues të Polonisë** K-37/05, datë 25 tetor 2005.

gëzon asnjë diskrecion: ajo/ai thjesht e materializon një detyrim ceremonial brenda funksionit të tij si kreu i shtetit. Presidenti nuk ka kompetencë ta nënshkruaj asnjë ligj, i cili nga GJKRKS është vlerësuar si kundërkushtetues. Në kuptim të kësaj praktike, nëse një ligj i caktuar është vlerësuar në ndonjë formë si kundërkushtetues nga ana e **GJKRKS**, atëherë kompetenca e Presidentit të Republikës nga ky paragraf nuk mund të shfrytëzohet për të nënshkruar një ligj të tillë.

Sa i përket paragrafit 6, Presidenti gëzon kompetencën për të rikthyer një ligj të caktuar në Kuvend nëse ligji i tillë, sipas vlerësimit të presidentit, është në kundërshtim me "interesat legjitime të Republikës së Kosovës ose të një a më shumë komuniteteve të saj". Kjo kompetencë është një **e drejtë vetoje suspensive** e Presidentit të Republikës, në kushtet e një sistemi qeverisës të pastër parlamentar. Për t'u ushtruar kompetenca e Presidentit të Republikës për ta kthyer një ligj të miratuar nga Kuvendi Kosovës, duhet të plotësohen këto kushte:

- që ligji të jetë miratuar në procedurë finale në Kuvendin e Kosovës dhe të jetë nënshkruar nga ana e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, sipas procedurës së ligjvënies; kjo nënkupton që një akt juridik i miratuar nga ana e Kuvendit, me përmbajtje të një ligji, nuk mund t'i procedohet Presidentit të Republikës për shpallje përpara se t'i ketë kaluar procedurat e miratimit final (p.sh. leximin e tretë ose leximin përkatës që kërkohet për prodhimin final të ligjit);
- në vlerësimin e ligjit, Presidenti i Republikës është i kufizuar në kontrollin e ligjit vetëm në dy aspekte:
  a) nëse ligji është në përputhje me interesat legjitime të Kosovës, që është një koncept që i lejon Presidentit të Republikës një diskrecion të gjerë vendosjeje dhe vlerësimi lidhur me atë se çka përfaqëson interes legjitim të vendit; dhe
  b) nëse ligji është në përputhje me interesat e një apo më shumë komuniteteve në Kosovë.

Presidenti mund ta kthej ligjin në rishqyrtim thjesht dhe vetëm mbi këto dy baza. Kjo e drejtë mund të shfrytëzohet vetëm një herë. Kjo është një kompetencë ku Presidenti ka diskrecion të plotë për të vlerësuar shfrytëzimin e saj, brenda përcaktimeve kushtetuese: vetëm parametrat e ankoruar në dispozitat e **KKos** mund të përdoren si themel për definim të konceptit "interesat legjitime të Republikës së Kosovës ose të një a më shumë komuniteteve të saj" nga paragrafi 6. Në materializimin e kësaj kompetence, megjithatë, Presidenti gëzon jo thjesht vetëm të drejtën e kontrollit të procedurës së ndjekur, por edhe të vetë substancës së ligjit. Nëse shikohen bazat mbi të cilat mund të shfrytëzohet kjo kompetencë e presidentit, është lehtësisht e kuptueshme që Presidenti duhet të veprojë në pozicionin e tij si përfaqësues i unitetit të popullit, jo thjesht në aspektin politik por edhe atë etnik, gjuhësor, fetar, orientimit seksual dhe në çdo aspekt tjetër që mund të çoj në diskriminim të qytetarëve të Kosovës pas hyrjes në fuqi dhe nisjes së zbatimit të ligjit. Ushtrimi i kësaj kompetence nga ana e presidentit duhet thjesht të shihet në publik si një veprim në harmoni me urdhrin kushtetues nga nenet 4.3 dhe 83 të KKos, që ka për qëllim arritjen e një objektivi që qëndron në linjë me parimet e natyrës unifikuese të shefit të shtetit.

Kjo kompetencë, në asnjë rast nuk nënkupton që Presidenti ka të drejtën e shfuqizimit, ndryshimit apo pezullimit të ligjeve që janë në fuqi.[98] Në të njëjtën kohë, kjo kompetencë nuk mund të interpretohet në mënyrë të atillë që të nënkuptoj se, Kuvendi ka të drejtë t'ia bart Presidentit të Republikës kompetencën për nxjerrjen e ligjeve: kjo mbetet një gjë absolutisht e ndaluar.[99]

Kompetenca për të rikthyer në shqyrtim një ligj në Kuvendin e Kosovës, në kuptimin e interpretimit sistemor, është lehtësisht e kalueshme nga ana e mazhorancës në Kuvend, meqë rivotimi i ligjit në fjalë duhet të bëhet me votat e shumicës së krejt deputetëve. Kjo nënkupton që, efektivisht, Kuvendi ka votuar sërish për versionin e vet, jo për veton e Presidentit të Republikës. Nëse Presidenti, megjithatë,

[98] Cf. më shumë në **Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Bjellorusisë**, Nr. J-18/95 i datës 27.10.1995.
[99] **Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Afrikës së Jugut**, Nr. CCT 27/95 i dates 22.09.1995.

vjen nga një parti që është pjesë e mazhorancës qeverisëse, apo nëse kontrollon një numër deputetësh që i përkasin mazhorancës, atëherë e drejta e tij për rikthim në rishqyrtim të një ligji mund të kthehet në një kundërbalancim dhe bllokim total të ligjit në fjalë, duke bërë që ky model vetoje të ketë kosto të lartë kontrolluese ndaj veprimtarisë legjislative të Kuvendit. Kjo zakonisht ndodh në sistemin semi-presidencial.[100] Nga kjo del se fuqia e kësaj të drejte të Presidentit të Republikës varet shumë nga numri i deputeteve që presidenti mund t'i kontrolloj brenda mazhorancës që ka votuar për ligjin në raundin e parë. Në çdo rast, e drejta për rikthim të ligjit nuk përfshin të drejtën për amendamentin. Kjo është kështu për faktin se bie ndesh **me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve**, ku presidenti nuk hyn në asnjërin prej tri pushteteve, siç e thamë më sipër: nëse ajo/ai dëshiron të ushtroj iniciativën e vet për ligjvënie, këtë mund ta bëj konform nenit 79 të **KKos**, i cili, ndër subjektet e nismës legjislative, liston edhe shefin e shtetit).[101] Deri më sot, **GJKRKS** ka pasur rastin të deklarohet vetëm një herë për këtë të drejtë të presidentit: në rastin KO 57/12, të datës 20 shtator 2012, shefi i shtetit kosovar kërkonte nga GJKRKS që t'i tregonte nëse ka pasur shkelje të së drejtës së saj të vetos nga neni 80.4 i KKos, me rastin e miratimit të **Ligjit nr. 04/1-084 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës** ("Ligji nr. 04/1-084"). Në këtë rast, **GJKRKS** vendosi se Presidenti, duke kthyer ligjin në Kuvend për rivotim, kishte gabuar kur kishte bërë amendamente në ligj, sepse kjo nuk është e drejtë e Presidentit të Republikës. Siç u tha më sipër, Presidenti i Republikës ka iniciativën legjislative sipas nenit 79 të Kushtetutës: ajo/ai mund ta shfrytëzoj këtë të drejt për të propozuar ligje tërësisht të reja, në kuadër të realizimit të kompetencave të veta si shef i shtetit. Në këtë rast, presidentja e Kosovës, zonja **Atifete Jahjaga**, në mënyrë të gabuar kishte kthyer për rivotim **Ligji nr. 04/1-084**, duke vënë në të disa amendamente të reja, në vend se të theksonte arsyet e kthimit të ligjit siç kërkon dispozita e nenit 80.3 të KKos. Këtë kërkesë të saj, Kuvendi e kishte rrëzuar me plot të drejt: Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, kishte vendosur për miratimin e **Ligji nr. 04/1-084**, të rikthyer nga zonja Atifete Jahjaga, ashtu që ai u konsiderua i shpallur konform nenit 80.4 të **KKos**.

Paragrafi shtatë i nenit 84 i jep Presidentit të Republikës kompetencën për të nënshkruar **marrëveshjet ndërkombëtare**, në pajtim me **KKos**, e cila parasheh dy lloje të marrëveshjeve ndërkombëtare: a) marrëveshjet ndërkombëtare që duhen ratifikuar në Kuvend (neni 82.1 dhe 64.4 të **KKos**);[102] dhe b) marrëveshjet ndërkombëtare që ratifikohen vetëm me nënshkrimin e Presidentit të Republikës (neni 82.2 i **KKos**).[103] Në rastin e marrëveshjeve të para, kompetenca për të bërë marrëveshje ndërkombëtare dhe për të negociuar substancën e tyre, i takon Kuvendit dhe ekzekutivit, pra është një kompetencë e ndarë. Autorizimin për negocimin e tyre dhe për zhvillim të tratativave të tjera deri në ratifikim e jep Presidenti. Në rastin e traktateve të dyta, kompetenca për të bërë marrëveshje ndërkombëtare dhe për të negociuar substancën e tyre i takon plotësisht Presidentit. Ky paragraf, i jep Presidentit diskrecion vlerësimi nëse dëshiron ta nënshkruaj apo jo një marrëveshje të caktuar ndërkombëtare, përveç atyre nga neni 18.1 i Kushtetutës. Kjo nënkupton që marrëveshjet nga paragrafi i dytë i nenit 82 lidhen brenda

---

100 Cf. argumentin për modelin francez dhe modelet tjera semipresidenciale në shkrimet si vijon: Ezra N. Suleiman, "Presidentialism and Political Stability in France". Në Juan J. Linz and Arturo Valenzuela (eds.), *The Failure of Presidential Democracy*, Vol. 1 (The Johns Hopkins Univesity Press: Baltimore Maryland and London, 1994), fq. 137-162; Steven D. Roper, "Are All Semipresidential Regimes the Same? A Comparison of Premier-Presidential Regimes: *Comparative Politics* Vol. 34 No. 3 (April 2002), fq. 253-272; Ezra N. Suleiman, "Presidentialism and Political Stability in France". Në Juan J. Linz and Arturo Valenzuela (eds.), *The Failure of Presidential Democracy*, Vol. 1 (The Johns Hopkins Univesity Press: Baltimore Maryland and London, 1994), fq. 137-162.

101 Cf. paragrafët 62-77 të Aktgjykimit në rastin KO57/12 "Kërkesa e Presidentes së Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së Saj, Atifete Jahjaga, me të cilën konteston votimin për miratimin e Ligjit Nr. 04/1-084 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës". Nr. ref.: AGJ297/12. Datë 20 shtator 2012.

102 Neni 82. 1 i **KKos**:
"Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje: (1) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake;
(2) të drejtat dhe liritë themelore; (3) anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare; (4) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës".

103 Cf. Neni 82.2 i **KKos**: "Marrëveshjet ndërkombëtare me përjashtim të atyre në pikën 1, ratifikohen pas nënshkrimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës".

suazave të kompetencave kushtetuese që ka Presidenti i Republikës. Në Kosovë nuk bëhet dallimi në mes të traktateve ndërkombëtare ("international treaties") dhe marrëveshjeve ndërkombëtare" ("international agreements"), siç bëhet në disa vende (Franca, SHBA).[104] Aty ku ekziston, ky dallim nuk është semantik por përmbajtësor: te rasti i traktateve ndërkombëtare, ratifikimi bëhet nga organi përfaqësues ose njëra prej dhomave të tij dhe për nga natyra e tyre janë të ngjashme me marrëveshjet nga neni 82.1 i **KKos**, kurse te marrëveshjet ndërkombëtare ratifikimi dhe hyrja e tyre në fuqi gjenden në duart e shefit të shtetit pse të ekzekutivit. Në rastin e traktateve ndërkombëtare, substancën e tyre nuk e dikton ekzekutivi, por organi përfaqësues, kurse të marrëveshjet ndërkombëtare këtë e bën vetë ekzekutivi ose shefi i shtetit. Në SHBA, një lloj i posaçëm i marrëveshjeve ndërkombëtare janë të a.q".executive agreements" apo marrëveshjet ekzekutive, të cilat i lidh presidenti i **SHBA-së** në vijim të ushtrimit të funksioneve të veta si shef ekskluziv i ekzekutivit amerikan. Si të tilla, marrëveshjet ekzekutive kanë lindur nga përvoja kushtetuese e presidentëve amerikanë, jo që janë të përcaktuara me **KAm**, gjatë përpjekjeve të tyre për të shmangur procedurat e ratifikimit në Senat të marrëveshjeve ndërkombëtare të lidhura nga ta.[105]

Sikundër u tha, negocimi i çfarëdo marrëveshje ndërkombëtare, përveç atyre nga neni 18.2 i **KKos**, mund të bëhet vetëm nën autorizimin e dhënë nga ana e Presidentit të Republikës. Në të kundërtën, negocimi i substancës së një marrëveshjeje ndërkombëtare pa autorizimin paraprak të dhënë nga ana e Presidentit të Republikës, përveç atyre nga neni 18.2 i **KKos**, substancën e të cilave e përcakton neni 84.7 lidhur me nenin 93.1 të KKos. Ato nga neni 82.1., ndërkaq, negociohen (dhe tratativat për to zhvillohen) në koordinim të plotë mes ekzekutivit dhe Presidentit të Republikës, sipas autorizimit të këtij të fundit. Autorizimi i këtij të fundit kërkohet për shkak të dispozitës së nenit 84.10 të **KKos**.

Marrëveshjet dhe traktatet ndërkombëtare, për të cilat u fol deri më tani në kuadër të kompetencave të Presidentit të Kosovës, janë aktet juridike ndërkombëtare në kuptim të **Konventës së Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve** (KVDT). Kjo nënkupton që marrëveshjet dhe traktatet ndërkombëtare të pashkruara, pra marrëveshjet dhe traktatet ndërkombëtare verbale, nuk hyjnë në kuadër të kuptimit të këtij paragrafi, sepse natyra parlamentare e sistemit kosovar të qeverisjes, për dallim nga rastet e sistemit presidencial, nuk lejon një mundësi të tillë. Krijimi i marrëveshjeve ndërkombëtare nga neni 82.2 i **KKos**, të cilat i lidhin ekzekutivi dhe shefi shtetit, presupozojnë ekzistimin e një detyrimi paraprak ndërkombëtarë, që buron nga KKos, ligji ose ndonjë detyrim tjetër ndërkombëtar i marrë përsipër nga organet kushtetuese të Kosovës.

Paragrafi tetë i nenit 84 i jep të drejtën Presidentit të Republikës për të propozuar amendamente kushtetuese, të cilat pastaj hyjnë në procedurën e miratimit sipas përcaktimit të vet KKos. Ky paragraf e bën presidentin aktor në procesin e amendamentimin kushtetues. Logjika prapa kësaj të drejte lidhet me mundësinë që Presidenti të ketë hapësirën e duhur për të materializuar konceptin e **përfaqësimit të unitetit të popullit** duke propozuar amendamente kushtetuese që kanë për qëllim një objektiv të tillë. Shikuar në ndërlidhshmëri me nenin 83, ky paragraf detyron Presidentin e Republikës që shfrytëzimin e kësaj të drejte ta bëj në kuptim të funksionit të saj/tij si përfaqësues i unitetit të popullit dhe substancializimit të qëllimeve nga ky funksion. Një shembull shumë i mirë ekziston, në kuptim të precedentit gjyqësor, në **Sllovaki**: gardiani i kushtetutës në këtë vend ka vendosur që njëra nga katër pyetjet e ref-

[104] Duke përshkruar kompetencat e Kuvendit të Kosovës, kushtetutëbërësi kosovar përdor shprehjen ratifikim, kur saktëson se përfaqësuesi i sovranit në Kosovë ratifikon traktatet ndërkombëtare (neni 65.4 I KKos). Kjo fjali, megjithatë, nuk ka asnjë relevancë për qëllimet e dallimit në mes të marrëveshjeve dhe traktateve ndërkombëtare, siç ekziston gjetiu nëpër botë.

[105] Cf. Më shumë për modelin e ikjes nga procedura e vështirë e ratifikimit, të cilën e shfrytëzojnë presidentët amerikanë, përmes lidhjes së marrëveshjeve ekzekutive me shtetet tjera, në shkrimet si vijon: Lisa L. Martin, "The President and International Commitments: Treaties as Signaling Devices". *Presidential Studies Quarterly*. Vol. 35 No. 3 (September 2005), fq. 440-465; Glen S. Krutz and Jeffrey S. Peake, "The Changing Nature of Presidential Policy Making on International Agreements". *Presidential Studies Quarterly*. Vol. 36 No. 3 (September 2006), fq. 391-409; Louis Fisher, "The Law Treaty Negotiation: A Presidential Monopoly?" *Presidential Studies Quarterly*. Vol. 38 No. 1 (March 2008), fq. 144-158.

erendumit, e parashtruar nga presidenti, nuk ishte në harmoi me kushtetutën e vendit dhe ligjet në fuqi, për shkak se në kushtetutën e këtij vendi nuk ekziston asnjë dispozitë që lejon një autoritet të propozoj amendamente kushtetuese në formën e pyetjes referendumiane, ashtu siç kishte bërë presidenti.[106] Kjo, siç shihet, ka ngjashmëri të madhe me amendamentimin ligjor të propozuar nga **A. Jahjaga** në rastin e **Ligji nr. 04/1-084**, të diskutuar më sipër. E parë nga prizmi përvojës sllovake, neni neni 84.8 i **KKos**, në asnjë mënyrë nuk duhet të lexohet si një autorizim për Presidentin e Republikës që të vendos në referendum një propozim të tij për amendamente kushtetuese.

Paragrafi nëntë ia veshë të drejtën Presidentit të Republikës për të referuar çështje në **GJKRKS**. Shikuar në aspektin e përgjithshëm, pozita e palës së legjitimuar për të referuar çështje në GJKRKS i jep hapësirë Presidentit të Republikës për të materializuar në një mënyrë apo tjetër kompetencën e tij si ”garantues” i funksionimit kushtetues të institucioneve kushtetuese. Dy janë çështje të rëndësishme: a) çfarë lloj pyetjesh mund të referoj Presidenti i Republikës në kuptim të këtij neni?; dhe b) çfarë është efekti juridik i pyetjes që bën Presidenti i Republikës?

Sa i përket pyetjes së parë, në kuptim të këtij paragrafi, nocioni ”çështje kushtetuese“ mund të kuptohet në dy kuptime, të ngushtë dhe të gjerë. Në kuptim të gjerë, termi ”çështje kushtetuese“ i referohet çdo parashtrese që Presidenti mund të dërgoj në **GJKRKS** dhe që përmban një kërkesë të caktuar. Në kuptim të ngushtë, parashtresa që mund ta dërgoj presidenti mund dhe duhet konsideruar vetëm në kuptim të atyre çështjeve brenda juridiksionit të rregullt të **GJKRKS**, përcaktuar nga neni 113.2 (pikat 2 dhe 3) të **KKos**. Kjo do të thotë se pyetjet që mund t’i dërgojë në **GJKRKS** Presidenti duhen parë në kontekst të plotësimit të kushteve që lidhen me juridiksionin e vet **GJKRKS** të përcaktuar me **KKos**. Prandaj, nocioni ”çështje kushtetuese“ nuk i referohet çfarëdo lloj pyetjeje, por një parashtrese që e vë në lëvizje cilindo juridiksion të cilin e ka **GJKRKS** sipas **KKos.** Sikundër u tha më sipër, në praktikën e deritanishme të **GJKRKS** megjithatë, nuk ka gjetur zbatim kuptimi i ngushtë por ai i gjerë i termit ”çështje kushtetuese“. Ky përfundim rrjedh nga analizimi i disa rasteve të cilat janë ngritur pranë **GJKRKS**, njëri prej të cilëve është ngritur nga qeveria duke u mbështetur në formulimin tërësisht të njëjtë të nenit 93.10 të Kushtetutës ku thuhet se qeveria, **inter alia**, “mund të referoj çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese“.[107]

---

106 Cf. **Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë**, Nr. II.US 31/97, datë 21 maj 997.

107 Rasti i parë kërkesës për sqarim të cilin nga **GJKRKS** e kërkonte qeveria, në bazë të nenit 93.10 të **KKos** i referohej një kërkese për sqarim të bërë nga qeveria, sërish në bazë të nenit 93.10 të Kushtetutës, me të cilin kërkohej nga **GJKRKS** që të bënte të qartë për qeverinë nëse duhen proceduar në Kuvend me zgjedhjen e shefit të shtetit nëse paraprakisht dihet që nuk do të ketë në sallë mbi tetëdhjetë (80) deputetë, kurse në rastin e dytë nga **GJKRKS** u kërkua një interpretim abstrakt, tekstual, i dispozitave të neneve përkatëse të **KKos** që flasin për imunitetin dhe privilegjet e funksionarëve të lartë të shtetit të Kosovës. Më një fjalë, këtu Qeveria kishte kërkuar që **GJKRKS** të sqaronte caqet dhe vëllimin e imunitetit dhe privilegjeve të funksionarëve të lartë shtetërorë të Kosovës.Derisa në rastin e parë **GJKRKS** kishte refuzuar shqyrtimin meritor të rastit sepse bazohej në një gjendje hipotetike që pritej të ndodhte në të ardhmen, pra votimi i shefit kosovar të shtetit pas vendimit të **GJKRKS** që shpallte antikushtetues vendimin e Kuvendit për zgjedhjen e z. **Behgjet Pacolli** për president të Kosovës më 22 shkurt 2011, në rastin e dytë **GJKRKS** shqyrtoi meritat e rastit. Ato merita të rastit të dytë kishin të bënin jo me një gjendje faktike por më një interpretim abstrakt dhe hipotetik të neneve përkatëse të **KKos** që flasin për imunitetin dhe privilegjet e funksionarëve të lartë shtetëror të **Kosovës**. Me një fjalë, **GJKRKS** nuk vlerësoi kushtetutshmërinë e një norme ligjore të përmbajtur në një draft-ligj, as të një norme kushtetuese të përmbajtur në një draft-amendament kushtetues, por bëri interpretim abstrakt dhe tërësisht hipotetik të caqeve dhe vëllimit të imunitetit dhe privilegjeve të funksionarëve të lartë shtetëror.Sikundër mund të vërehet, në këto dy raste dhe në rastet e ngritura nga Presidenti dhe ushtruesi i detyrës së Presidentit, **GJKRKS** ka bërë një interpretim ekstensiv të juridiksionit të vet nga nenet 113, paragrafët 2 dhe 3 të **KKos**, duke pranuar si palë të autorizuar qeverinë dhe presidentin për ngritje të ”çdo çështje kushtetuese“ pranë **GJKRKS**. Kjo efektivisht do të thotë se cilësia e të qenurit president dhe qeveri përcaktojnë se çka është ”çështje kushtetuese“, jo juridiksioni i **GJKRKS** sipas nenit 113, pikat 2 dhe 3. Cilësimi që presidenti dhe qeveria ia bëjnë një çështje e përcakton juridiksionin e **GJKRKS** tani e tutje. Këtu kemi të bëjmë me vendime interpretuese, të cilat njihen në mënyrë shprehimore në disa vende, si p.sh. në Itali dhe deri vonë në Bullgari, por ka raste kur vetë gjykatat, si në rastin e Kosovës, kanë bërë interpretim ekstensiv të dispozitave kushtetuese për t’i krijuar vetes një juridiksion shtesë. Për rastin e **Italisë** dhe të **Bullgarisë**, Cf. më shumë në Herman Schwartz, *The*

Në rastin e parë, që ka nisur këtë praktikë, Presidenti kishte kërkuar që GJKRKS, bazuar në nenin 84.9 i cili përcakton se presidenti mund të referoj çështje kushtetuese në GJKRKS, të sqaronte për nevojat e tij se cili institucion ishte përgjegjës për të vlerësuar efektshmërinë dhe validitetin e dorëheqjes, me pasojë përfundimin eventual të mandatit të kryetarit të një komune që kishte dhënë dorëheqjen përmes një komunikate drejtuar qytetarëve, paqartësia e së cilës ia bënte të pamundur presidentit veprimin e mëtejshëm në përputhje me parimin kushtetues për zgjedhje të lira dhe të barabarta[108]. Rasti tjetër u paraqit nga ushtruesi i detyrës së Presidentit, dr. **Jakup Krasniqi**, po ashtu në bazë të nenit 84.9, i cili kërkonte që **GJKRKS** të jepte një sqarim nëse ushtruesit të detyrës së presidentit i ndalohej mbajtja dhe ushtrimi i postit të Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK).[109]

Sa i përket pyetjes së dytë, për sa më sipër, efekti juridik i parashtresës që mund ta dërgoj Presidenti është i njëjtë me efektin juridik të çdo pale tjetër të autorizuar. Në këtë aspekt, pyetjet që Presidenti mund t'i parashtroj në **GJKRKS** nuk kanë efekt juridik tjetër, pos të asaj të një pale të autorizuar që mund të vë në lëvizje juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese. Kjo nënkupton që **GJKRKS** duhet të prononcohet me vendim për pranueshmërinë dhe, eventualisht, për meritat e rastit të ngritur nga Presidenti Republikës. Sikundër u tha më sipër, nga vendimi në rastin **Rasti KO 130/15**, kjo praktikë është braktisur ashtu që **GJKRKS** shpall të papranueshme çdo kërkesë të Presidentit të Republikës që nuk ka të bëj me një akt në kuptim të nenit 113.2 (pikat 2 dhe 3 të **KKos**.[110]

Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme, gjithashtu, të kihet parasysh që kjo kompetencë e Presidentit të Republikës duhet spjeguar në kuptim të ngritjes së çështjeve në **GJKRKS** të cilat ajo/ai i has gjatë ushtrimit të kompetencave të garantuara me KKos e me qëllim të realizimit të rolit primar të Presidentit të Republikës si përfaqësues i **unitetit juridik-kushtetues** të popullit të Kosovës dhe si garantues i funksionimit normal të institucioneve të sistemit kushtetues kosovar.

Paragrafi dhjetë përcakton që Presidenti udhëheq politikën e jashtme të shtetit. Koncepti "udhëheq" mbetet pika më kontestuese e tërë autoritetit të Presidentit të Republikës. Dy janë kontestet kryesore: a) nëse koncepti "udhëheq" i përcaktuar me këtë paragaf njëkohësisht e përcakton presidentin si shefin e politikës së jashtme, i cili e udhëheq i vetëm politikën e jashtme të shtetit, pa asnjë bashkëvendimarrës? dhe, b) nëse në kuptim të këtij paragrafi ka ndonjë dallim në mes të konceptit "udhëheq" dhe "qeverisë"? Për ta shtruar këtë çështje në nivel më të ulët, duhet sqaruar që **KKos** njëkohësisht lejon mekanizma të tjerë qeverisës të cilët kanë kompetencën e marrjes me punët e jashtme të shtetit, siç është Qeveria, dhe atë në nivel të punëve primare.

Për ta shpjeguar në mënyrë krahasuese, koncepti i famoz francez i **Adolf Tier**, i cekur më sipër, që shefi i shtetit nuk qeverisë, duhet të jetë pika zbërthyese e këtij paragrafi, sado që ky koncept është

Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe (The University of Chicago Press: Chicago, 2000), fq. 164-193; Giancarlo Rolla and Tania Groppi, "Between Politics and the Law: The Development of Constitutional Review in Italy". Në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice East and West. Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in A Comparative Perspective* (The Hague Kluwer Law International: The Hague, 2010), fq. 143-159; Për rastin e krijimit të këtij juridiksioni përmes interpretimit ekstensiv të dispozitave kushtetuese, Cf. më shumë në Brewer-Carias, R., Allan (2011) *Constitutional Courts as Positive Legislators. A Comparative Law Study*. (Cambridge University Press: Cambridge, 2010), kapitulli 5 "Constitutional Courts as Legislators on Matters of Judicial Review" (fq.173-188). Në këtë kapitull, autori jep një analizë komparative të rasteve të gjykatave të cilat krijojnë rregulla materiale dhe procedurale në dobi të zgjerimit të juridiksionit të tyre vetanak. Për aktgjykimin e **GJKRKS**, të diskutuar këtu, cf. më shumë në: **Sqarim i Aktgjykimit** në rastin **KO 29/11** "Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë". Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04- V-04, të 22 shkurtit 2011, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, "Sqarimet e kërkuara për Vendimin e shumicës, të 30 marsit 2011", datë: me 1 prill 2011, Nr. ref.: SQ 111/11. Paragrafët 14-19; dhe Aktgjykimi për rastin **KO 98/11**.

108 Cf. Aktgjykimi në rastin **KO 80/10**, paragrafi 10.

109 Cf. Aktgjykimi në rastin **KO 97/10**.

110 Cf. fusnotat 92-95, **supra**, në këtë pjesë, dhe teksti që e shoqëron.

elaboruar në një kontest tjetër, përkatësisht në kontekstin e monarkive kushtetuese të shekullit XIX, më pastaj është pasuruar nga debati **Shmit-Kelsen** dhe praktikat kushtetuese të pas vitit 1945 e deri më sot. Koncepti "udhëheq", prandaj, duhet parë si një kompetencë josubstanciale, e vënë me këtë paragraf si një atribut formal i autoritetit të presidentit. Përkundër që ky paragraf e shënon në mënyrë shumë të qartë se "udhëheqja" e politikës së jashtme të shtetit është kompetencë e presidentit të shtetit, kjo nuk do të thotë se udhëheqja e politikës së jashtme bëhet pa u koordinuar dhe pa pëlqimin e qeverisë. Kjo nënkupton se Presidenti është udhëheqësi i vetëm i politikës së jashtme, por në sensin formal (josubstancial), sepse në këtë autoritet ai/ajo kufizohet dhe kushtëzohet nga Qeveria dhe Kuvendi, si organe respektivisht menaxhuese (Qeveria) dhe mbikëqyrëse (Kuvendi) të politikës së jashtme në një sistem të pastër parlamentar. Për ta shpjeguar më mirë këtë kompetencë kushtetuese, është e rëndësishme që të bëhet një dallim mes të rolit të Presidentit të Republikës dhe Qeverisë sa i përket politikës së jashtme. Në kuptim të këtij paragrafi, duhet kuptuar që rolin "udhëheqës" të politikës së jashtme e bartë Presidenti, përderisa qeverisjen (menaxhimin) e politikës së jashtme e bën qeveria e shtetit, si organ politik i pajisur me aparat profesional në fushën e politikës së jashtme.

Në aspektin teknik, kjo ndarje në mes të rolit udhëheqës të politikës së jashtme, që është kompetencë e Presidentit të Republikës dhe rolit qeverisës/menaxhues të politikës së jashtme, që është kompetencë e Qeverisë, konsiston në këto dallime: a) udhëheqja e politikës së jashtme nënkupton të drejtën për të përcaktuar objektivat dhe linjat e drejtimit të politikës së jashtme, kurse qeverisja e politikës së jashtme nënkupton menaxhimin e mekanizmave për të arritur objektivat e përcaktuara; b) udhëheqja e politikës së jashtme nënkupton të drejtën e përfaqësimit më të lartë të shtetit në botën e jashtme, ndërsa qeverisja e saj nënkupton menaxhimin e instrumenteve në përfaqësimin e nivelit të dytë të Kosovës në botën e jashtme.

Prandaj, koncepti i udhëheqjes së politikës së jashtme e vendos Presidentin e Republikës në pozicion të përcaktorit të linjave/ drejtimeve dhe objektivave të politikës së jashtme të shtetit, përderisa qeveria (përkatësisht, organi i saj administrativ - ministria e jashtme) e bën materializimin e linjave të përcaktuara nga ana e presidentit. Në përgjithësi, ky paragraf e vendos një hierarki në kontekst të politikës së jashtme sa i përket institucionit të Presidentit të Republikës dhe Qeverisë: është qartësisht e pranueshme që Presidenti i Republikës është autoriteti më i lartë i definimit të vijave të përgjithshme në politikën e jashtme, përderisa Qeveria i zbërthen këto vija dhe, pas miratimit të tyre në Kuvend, iu nënshtrohet atyre dhe i zbaton në praktikë. Kjo për faktin se pas miratimit në Kuvend, ato vija të definuara nga presidenti dhe të përcaktuara nga Qeveria kthehen në objektiva të politikës së jashtme që duhen vënë në jetë përmes mekanizmave qeverisës.[111] Sikundër shihet, në të njëjtën kohë, në vijim të përcaktimit të vijave të trasha të politikës së jashtme, Qeveria dhe presidenti ndihmohen dhe ndikohen nga Kuvendi, i cili gjatë ushtrimit të funksionit të tij mbikëqyrës, sipas nenit 65.12, të **KKos**, mund t'i bëj të qarta kahet e politikës së jashtme që kanë të bëjnë me çështjet kyçe të politikës së jashtme, veçanërisht kur bëhet fjalë për ato nga neni 18.1 i **KKos**. Kjo reflektohet edhe në aspektet tjera të politikës së jashtme, siç janë përzgjedhja dhe emërimi i stafit diplomatik, të cilat kalojnë nëpër vendimmarrjen zinxhirore deri te Presidenti. Prirja e delegacioneve jashtë vendit, ku përfaqësohet Kosova, gjithashtu hyn në prerogativat e udhëheqjes me politikën e jashtme.

Paragrafi njëmbëdhjetë përcakton kompetencën e presidentit për të pranuar letrat kredenciale të shefave të misioneve diplomatike të akredituara në Republikën e Kosovës. Kjo kompetencë e

[111] Siç është vendosur nga një vendim i **Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë**, në ushtrimin e detyrave të tij për të kërkuar raporte nga qeveria apo ministra të caktuar, siç mund të jetë rasti kushtetues i kërkimit të përgjegjësisë për zbatimin e politikës së jashtme, presidenti nuk duhet të imponojë as procedura sesi të përgatitet raporti e as afat kohor për dorëzimin e raportit të tillë. Një qëndrim i tillë, që vlen tërësisht edhe për kontekstin kushtetues kosovar, ka për qëllim që të ruaj balancën në mes pushteteve dhe njëkohësisht që të mos ndërtoj linja të kontrollit ndaj qeverisë që dalin jashtë kuptimit të kësaj norme. Cf. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë, No. I. US 7/96 i datës 11.07.1996.

Presidentit të Republikës është detyrë tipike e kreut të shtetit, e cila ka kryesisht funksion ceremonial. Në kuptim të pranimit të letrave kredenciale të diplomatëve të huaj, Presidenti materializon detyrën e tij si përfaqësuesi më i lartë i shtetit në vend dhe në botën e jashtme. Përveç rëndësisë formale, për dallim nga paragrafi paraprak, ky paragraf nuk ka ndonjë rëndësi substanciale për autoritetin e Presidentit të Republikës.

Paragrafi dymbëdhjetë përcakton kompetencën e Presidentit të Republikës si komandant suprem i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Në kuptimin real, ky paragraf e bën Presidentin e Republikës shef të forcave të armatosura të shtetit si në kohë lufte ashtu edhe në kohë paqeje. Të qenurit komandant suprem, megjithatë, edhe në kuptim të këtij paragrafi, nuk nënkupton që Presidenti është politikbërësi dhe udhëheqësi i politikës ushtarake të shtetit. Prandaj, ky paragraf duhet lexuar thjesht në kuptimin teknik, si një kompetencë e Presidentit për të komanduar, jo për të përcaktuar politikën publike të ushtrisë së Kosovës. Në materializimin e kësaj të drejte, Presidenti më shumë vepron si një autoritet formal, në kuptim të kreut të shtetit, sesa si një komandant praktik dhe real i forcave në fjalë.

Paragrafi trembëdhjetë përcakton kompetencën e Presidentit për të udhëhequr këshillin konsultativ për komunitete (KKK), një organ kushtetues me mision mbrojtjen e interesit të komuniteteve, që qëndron në lidhje të ngushtë me nenin 60 të **KKos** që përcakton fizionominë kushtetuese të **KKK**. Në kuptim të këtij paragrafi, koncepti i ”udhëheqjes” me **KKK** nënkupton që ai është një organ i Presidentit të Republikës dhe jo një trup kolegjial. Prandaj, Presidenti udhëheq dhe qeverisë me **KKK**, përkundër që të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve supozohet se janë të përfaqësuar në procesin e vendimmarrjes në të. Pozita e udhëheqësit të KKK, dhe në përgjithësi pozicioni i KKK pranë Presidentit të Republikës, i jep ngjyrë përfaqësimi të unitetit të popullit në kuptim të interesave të komuniteteve të Kosovës. Në këtë mënyrë, kjo kompetencë e Presidentit të Republikës qëndron në përputhje me konceptin e multietnicitetit, barazisë para ligjit, mosdiskriminimit dhe parimeve e vlerave tjera të proklamuara dhe të mbrojtura nga **KKos**. Kjo kompetencë shërben si një autorizim për shefin kosovar të shtetit për të mbikëqyr realizimin e **demokracisë konsociacionale** që sanksionohet me **KKos**.

Paragrafi katërmbëdhjetë e veshë Presidentin me autoritetin për të caktuar mandatarin për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike ose koalicionit të partive që përbëjnë mazhorancën në Kuvend. Shikuar në aspektin krahasues, kjo është një kompetencë tipike e Presidentit të Republikës në kuptim të funksionit të tij si kreu i shtetit. Dy gjëra janë të rëndësishme në këtë aspekt: a) nëse Presidenti i Republikës ka të drejt ta kthej një kandidaturë për kryeministër, edhe nëse propozohet nga partia/koalicioni i partive që kanë fituar shumicën në Kuvend?; dhe b) nëse Presidenti i Republikës gëzon të drejtën që ta caktoj mandatarin e Qeverisë pa marrë propozimin e partisë/koalicionit që ka fituar shumicën e vendeve në Kuvend?

Materializimi i kompetencës së presidentit për mandatimin e kandidatit për kryeministër, në kuptim të këtij paragrafi, nënkupton që Presidenti është i lidhur dhe nuk ka diskrecion në vendosjen e kësaj çështjeje. Në rend të parë, kjo nënkupton se Presidenti këtë kompetencë e ushtron thjesht në aspektin formal, si kreu i shtetit: Presidenti nuk ka të drejt ekzekutive për të gjykuar nëse kandidati i propozuar nga partia/koalicioni që ka fituar shumicën, është i përshtatshëm. Këtë kompetencë, së dyti, Presidenti i Republikës e ushtron duke ndjekur pas propozimin e dhënë nga partia/koalicioni që ka fituar shumicën e votave në Kuvend dhe nuk gëzon të drejt që të mos e pranoj/refuzoj kandidatin e propozuar. Së fundi, si rrjedhojë e dy konstatimeve si më sipër, Presidentit të Republikës, në kuptim të këtij paragrafi, i ndalohet që të caktoj një mandatar pa e marrë propozimin nga pala e autorizuar.[112] Mund të thuhet se,

[112] Në këtë kuptim, duhet argumentuar që caktimi i mandatarit për kryeministër është çështje e partisë/koalicionit politik dhe, në këtë linjë, presidenti është vetëm një zëdhënës i vendimit që marrin partitë politike. Cf. më shumë

në përgjithësi, kompetenca e Presidentit të Republikës për të caktuar mandatarin e Qeverisë është një detyrë ceremoniale, që nuk nënkupton të drejtën e tij për të refuzuar apo kërkuar ndryshimin e kandidatit që propozon partia/koalicioni fitues.

Paragrafët pesëmbëdhjetë dhe **gjashtëmbëdhjetë** përbëjnë të ashtuquajturat kompetenca gjyqësore të Presidentit të Republikës.[113] Sipas përcaktimit të këtyre dy paragrafëve, Presidenti i Republikës emëron dhe shkarkon kryetarin dhe gjyqtarët e **GJSKos**, sipas propozimit të **Këshillit Gjyqësor të Kosovës** (KGJK). Çështja e nocionit ”emërim”, sipas përcaktimit të këtij paragrafi, duhet shikuar me shumë kujdes. Është e rëndësishme të ceket se pavarësia e gjyqësorit kërkon integritet dhe kredibilitet në procesin e zgjedhjes, promovimit dhe shkarkimit të gjyqtarëve. Kjo nënkupton se është vështirë e pranueshme që koncepti ”emërim” dhe ”shkarkim” siç përcaktohet me këta dy paragrafë, të nënkuptoj një kompetencë të pavarur të Presidentit të Republikës, për faktin e thjeshtë se shefi shtetit në një sistem parlamentar nuk ka mekanizma kushtetues për të kryer misione e funksione të mbledhjes dhe verifikimit të fakteve që kanë të bëjnë me vënien në jetë të kompetencave vetjake kushtetuese. Kjo mungesë lidhet me natyrën e sistemit parlamentar, ku shefi shtetit vihet në pozitën e mbikëqyrësit dhe verifikuesit të vendimmarrjeve të organeve të tjera kushtetuese, më të cilat nuk qëndron në raport vertikal, por shërben si një organ me autorizime neutrale dhe të ndërmjetme kushtetuese që për qëllim parësor kanë kontrollin dhe balancimin e pushteteve të tjera klasike dhe sigurimin e unitetit juridik – kushtetues të popullit dhe shtetit dhe garantimin e funksionimit normal të institucioneve të sistemit shtetëror. Në këtë aspekt, komentimi logjik i këtyre dy koncepteve kushtetuese, të ndërlidhura me funksionin kushtetues të **KGJK-së** si sigurues/garantues i meritës së profesionit të gjyqtarëve, nënkupton që kompetenca e presidentit për ”emërim” dhe ”shkarkim” duhet të komentohet thjesht në aspektin formal, si një vendimmarrje zinxhirore me efekt mbikëqyrës dhe ceremonial: emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve, Presidenti i Republikës e bën duke u bazuar (dhe duke u mbështetur) në propozimin e **KGJK-së**, përkatësisht duke ndjekur ngurtësisht propozimet e tij. Në këtë kuptim, Presidenti nuk mund të kontrolloj meritën e ”propozimeve” që vijnë nga **KGJK-ja**, që nënkupton se ajo/ai nuk mund të ushtroj kontroll substancial mbi propozimet e **KGJK-së**. Presidenti është thjesht i ”detyruar” që t’i konfirmoj propozimet e tilla. E vetmja hapësirë që mund të shfrytëzohet nga ana e presidentit sa i përket propozimeve të **KGJK-së** është kontrolli i rregullsisë së tyre procedurale: pra, nëse ato propozime janë nxjerrë në procedurën e paraparë juridike. Nëse procedura e dhënies së propozimeve ka qenë në rregull, atëherë Presidenti është i ”detyruar” që të konfirmoj propozimet e **KGJK-së** në formë të ”emërimeve” apo” shkarkimeve”.

Çdo interpretim ndryshe i këtyre dy paragrafëve do të nënkuptonte të drejtën e presidentit për të ushtruar kontroll substancial ndaj propozimeve të **KGJK-së**, pra të drejtën që presidenti të gjykoj meritat e propozimeve të tilla. Në një situatë të tillë, kjo do të përbënte ndërhyrje të drejtpërdrejtë në pavarësinë e gjyqësorit dhe në vet rolin e **KGJK-së** si garantues i vetëm i pavarësisë së gjyqësorit në kuptim të meritës së kryerjes së funksionit nga ana e gjyqtarëve. Për pasojë, në përgjithësi, shikuar edhe në përputhje me dispozitat kushtetuese mbi **KGJK-në**, gjyqësorin dhe standardet ndërkombëtare mbi emërimet, shkarkimet dhe promovimin, këta dy paragrafë i japin detyrimin presidentit që thjesht të ”konfirmoj”, pra që të mos ketë të drejtë t’i refuzoj propozimet e **KGJK-së**, përveç nëse presidenti arsyeton që propozimet e tilla të KGJK-së kanë shkelur procedurat e parapara sipas **KKos**, ligjeve dhe rregullativës tjetër që normon këtë aspekt të gjyqësorit Duhet thënë këtu që kjo kompetencë e Presidentit të Republikës, siç është vendosur edhe nga **Gjykata Kushtetuese e Afrikës së**

në Mauro Calise, Mauro (1994) ”The Italian Particracy: Beyond President and Parliament”. *Political Science Quarterly*. Vol. 109 No. 3 (1994), fq. 441- 460.

113 Një shembull se si kompetencat gjyqësore në asnjë mënyrë nuk mund të nënkuptohet si të tilla që t’i lejojnë presidentit kryerjen e çfarëdo funksioni gjyqësor, është vendimi i **Gjykatës Supreme të Meksikos** e cila ka vendosur që urdhrat për bastisje të lëshuara nga autoritetet administrative janë kundërkushtetues. Sipas Kushtetutës, dhe bazuar në parimin e paprekshmërisë së shtëpive të qytetarëve, vetëm organet gjyqësore kanë kompetence të lëshojnë urdhër për bastisje. **Vendim i Gjykatës Supreme të Meksikos**, Nr. 198 i datës 28.5.2003.

Jugut,[114] nuk mund të shfrytëzohet për të zgjatur apo shkurtuar mandatin e të emëruarit gjyqësor të Presidentit të Republikës, sepse një formë e tillë e shtrirjes së kësaj kompetence është absolutisht kundërkushtetuese.

Paragrafët shtatëmbëdhjetë dhe **tetëmbëdhjetë** përcaktojnë kompetencën e Presidentit të Republikës për të emëruar dhe shkarkuar kryeprokurorin dhe prokurorët e shtetit në Republikën e Kosovës, bazuar në propozimin e **Këshillit Prokurorial të Kosovës** (KPK).[115] I tërë argumenti dhe logjika e shfrytëzuar në komentimin e dy paragrafëve paraprakë gjen shprehje edhe në këta dy paragrafë. Për pasojë, nuk është i nevojshëm diskutim shtesë, me përjashtim të pozitës kushtetuese në dritën e këtyre dy paragrafëve, të ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës dhe kompetencat e tij/saj në rastet kur ky post aktivizohet. Në praktikë ka pasur raste kur ushtruesi i detyrës së Presidentit të Republikës nuk ka respektuar këtë detyrim kushtetues të definuar si më sipër. Në kohën prej shtatorit 2010 deri në prill të vitit 2011 pozita e shefit të shtetit kosovar është mbajtur nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, si ushtrues detyre i Presidentit të Republikës në pritje të zgjedhjes së presidentit të ri. Në këtë interval kohor, ushtruesi i detyrës së Presidentit të Republikës bëri disa emërime të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës. Në vijim të këtyre emërimeve, në të njëjtën kohë ai ka mohuar emërimin e disa gjyqtarëve pa dhënë asnjë arsye, qoftë procedurale apo materiale. Kjo rrethanë ka shërbyer si shkas për hartuesit e njëmbëdhjetë (XI) amendamenteve kushtetuese, njëri prej të cilëve, amendamenti VII, kufizonte të drejtat e ushtruesit të detyrës së presidentit të ardhshëm për të emëruar dhe shkarkuar gjyqtarë dhe prokurorë në të ardhmen kur të krijohej një situatë e tillë. Këtë pjesë të amendamentit shtatë (VII), **GJKRKS** e ka shpallur jokushtetues, sepse "drejtësia nuk mund të administrohet nëse gjyqtarët dhe prokurorët nuk janë në detyrë". Kjo nënkupton se, kjo e drejtë nuk mund të kufizohet në asnjë kohë se në çdo moment duhet të ketë gjyqtarë e prokurorë që kryejnë detyrat e tyre kushtetuese të administrimit të drejtësisë në Kosovë.[116]

Paragrafi nëntëmbëdhjetë përcakton kompetencën e Presidentit të Republikës për të emëruar gjyqtarët e GJKKo, sipas propozimit të Kuvendit.[117] Ky paragraf e veshë Presidentin e Republikës me kompetencën e emërimit të gjyqtarëve kushtetues. Katër janë pyetjet që duhen shpjeguar: a) nëse Presidenti i Republikës është i lirë të emërojë gjyqtarët kushtetues edhe pa propozimin e Kuvendit?; b) nëse Presidenti i Republikës mund të refuzojë një kandidat të propozuar nga ana e Kuvendit?;[118] c) mbi çfarë baze Presidenti i Republikës mund të refuzojë emërimin e gjyqtarëve

---

114 **Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Afrikës së Jugut**, Nr. CCT 53/11, 54/11, 62/11, i datës 29.07.2011.

115 Si shembull, **Gjykata Kushtetuese e Rusisë** ka vendosur që **Gjykata Kushtetuese e Federatës Ruse** në vendimin e saj të datës 1 dhjetor 1999 vendosi që Këshilli Federal (dhoma e lartë e parlamentit rus) nuk ka juridiksion për të lëshuar dekret për shkarkimin e prokurorit të përgjithshëm nga funksionet e tij, gjatë periudhës hetuese për vepër penale të ngritur kundër tij. Sipas Kushtetutës së Rusisë, dhe në mungesë të ndonjë norme tjetër legjislative, dekretet e tilla janë pjesë e detyrave të presidentit të Rusisë. Shih: **Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Federatës Ruse**, i dates 1 dhjetor 1999.

116 Cf. **Rastet KO. 29/12 dhe KO. 48/12**. A*ktgjykim. Amendamentet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012*. Prishtinë: datë 20 korrik 2012. Ref.: AGJ 284/12. Paragrafët 162-167.

117 Krahaso logjikën e raportit në mes të presidentit dhe Kuvendit me rastin e zgjedhjes dhe emërimit të gjyqtarëve të gjykatave të larta, në Matthew Soberg Shugart and John M. Carey, *Presidents and Assemblies. Constitutional Design and Electoral Dynamics* (Cambridge University Press: Cambridge, 1992); Alfred Stepan and Cindy Skach, "Constitutional Frameworks and Democratic Consolidation. Parliamentarism versus Presidentialism". *World Politics*.Vol. 46 No. 1 (October 1993) fq. 1-22. Cf. gjithashtu të njëjtën logjikë në sistemet e pastra presidenciale, në Mark A. Petersen, *Legislating Together: The White House and Capitol Hill from Eisenhower to Reagan* (Harvard University Press: Cambridge MA, 1993); Burke Shartel, "Federal Judges: Appointment, Supervision, and Removal: Some Possibilities under the Constitution". *Michigan Law Review*. Vol. 28 No. 5 (March 1930), fq. 485-529.

118 Shih një kritikë mbi modelin amerikan të marrëdhënies së presidentit me Kongresin sa i përket emërimit të gjyqtarëve federalë: Kevin J. McMahon, "Presidents, Political Regimes, and Contentious Supreme Court Nominations: A Historical Institutional Model". *Law and Social Inquiry*, Vol. 32 Issue 4 (2007), fq. 919-954.

të propozuar nga Kuvendi?; dhe ç) a nënkupton koncepti ”emërim” në kuptim të këtij paragrafi, edhe kompetencën e Presidentit të Republikës për shkarkimin e gjyqtarëve kushtetues? As këtu, në kuptim të këtij paragrafi, koncepti ”emërim” nuk nënkupton të drejtën e presidentit për të kontrolluar meritën profesionale/karrierën e kandidatëve, meqë, edhe në këtë rast, propozimi vjen nga Kuvendi, në të cilin kryhet filtrimi kandidatëve. Zyra e Presidentit nuk ka mekanizëm institucional për kryerjen e verifikimeve të gjendjeve faktike lidhur me kandidatët. Këto gjëra i kryejnë organet tjera, në këtë rast **Kuvendi i Kosovës**, njëjtë sikur **KGJK-ja** dhe **KPK-ja**. Në këtë rast, megjithatë, ka një dallim substancial: këtu bëhet fjalë për gjyqtarë që nuk janë profesionistë në karrierë, që përzgjidhen dhe avancohen me kritere të trupave profesionalë, por për individë që marrin detyrimet e gjyqtarit kushtetues vetëm nëse plotësojnë kushtet formale të përcaktuara me **KKos** dhe **Ligjin për GJKRKS**. Kuvendi, përmes një komisioni përkatës bën intervistimin dhe seleksionimin e kandidatëve, që më pastaj i voton me kritere politike. Fundja, vetë Kuvendi është organ politik, jo organ profesional. Një gjendje e ngjashme është edhe gjetiu nëpër vendet e **Evropës** dhe në **SHBA**.[119] Në këtë kontekst, koncepti ”emërim” sipas këtij paragrafi nënkupton të drejtën e presidentit për të kontrolluar vetëm procedurën kushtetuese dhe ligjore, jo edhe substancën/meritën e propozimeve të Kuvendit. Prandaj, në kuptim të këtij paragrafi, Presidenti nuk mund t’i refuzoj kandidatët e propozuar nga Kuvendi për arsye të meritës apo karrierës së propozimeve. Sa i përket pyetjes tjetër, për rrjedhojë, Presidenti, megjithatë, emërimin mund ta materializojë vetëm në bazë të propozimit të Kuvendit, në asnjë mënyrë pa pasur mbështetje në të. Koncepti ”emërim”, në të njëjtën kohë, në kuptim të këtij paragrafi, nuk nënkupton kompetencën e presidentit për të shkarkuar gjyqtarë kushtetues, meqë shkarkimi i gjyqtarëve kushtetues bëhet përmes një procedure të përcaktuar me nenin 118 të **KKos**.[120]

Paragrafi njëzetë përcakton kompetencën e Presidentit të Republikës për të emëruar komandantin e FSK-së, në bazë të rekomandimit të kryeministrit. Kjo është një kompetencë e ndarë e Presidentit të Republikës me kryeministrin, që nënkupton që Presidenti mund të emëroj një kandidat për pozitën e komandantit të FSK-së vetëm në bazë të rekomandimit të kryeministrit. Prandaj, vendimi i presidentit për emërim të një kandidati duhet të jetë detyrimisht i lidhur me një propozim të kryeministrit, në të kundërtën, procedura e emërimit do të konsiderohej në kundërshtim me këtë paragraf.

Paragrafi njëzetenjë përcakton kompetencën e përbashkët që presidenti dhe kryeministri kanë për të emëruar drejtorin, zëvendësdrejtorin dhe inspektorin e përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI). Ky paragraf përcakton një kompetencë të ndarë në mes të presidentit dhe kryeministrit, sipas logjikës së një procedure bashkëvendimarrëse. Bashkëvendosja në mes të Presidentit të Republikës dhe kryeministrit në lidhje me emërimin e shefave të AKI-së shpreh edhe logjikën që AKI-ja qëndron mbi një substrat politik të cilin e përbën konsensusi politik i presidentit dhe kryeministrit. Ky model konsensusi, në anën tjetër, arsyetohet me kërkesën që bartësit e AKI-së të jenë figura, integriteti i të cilëve është kontrolluar nga një konsensus i Presidentit të Republikës

---

119 Krahaso këtë argument me atë te Mark Silverstein, *Judicious Choices: The New Politics of Supreme Court Confirmations* (W.W. Norton and Company: New York, 1994); Henry Paul Monaghan, “The Confirmation Process: Law or Politics”. *Harvard Law Review*. Vol 101 No. 6 (1988), fq. 1202-1212. Në të gjitha vendet perëndimore, me përjashtim të **Greqisë**, parlamentet janë të involvuara në nominimet (propozimet) e kandidatëve. Në rastet kur caktimi i gjyqtarëve ndahet në mes të disa organeve qendrore (gjyqësori, parlamenti dhe shefi i shtetit) atëherë nuk shtrohet fare çështja e vlerësimit të meritave të kandidatëve sepse ata bëhet gjyqtarë në momentin e caktimit të tyre nga organi qendror caktues. Nga kjo shihet se problemi i vlerësimit të meritave të kandidatëve del vetëm në rastet kur nominimet (propozimet) dalin nga votimi në parlament, të cilat më pastaj kërkojnë emërim (dekretim) nga shefi i shetit. Cf. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Models of Constitutional Jurisdiction* (Council of Europe Press: Strasbourg, 994), fq. 40-45.

120 Neni 118 [Shkarkimi] i **KKos**: “Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese mund të shkarkohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës me propozimin e dy të tretave (2/3) të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, vetëm për kryerjen e krimeve të rënda ose për mospërfillje të rëndë të detyrave“.

dhe kryeministrit. Si procedurë, kjo paraqet një lloj garancioni për kredibilitetin konsensual (pra, jopolitik) që duhet të kenë bartësit e AKI-së.

Paragrafi njëzetedy përcakton kompetencën e Presidentit të Republikës për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, sipas konsultimit me kryeministrin. Kjo është një kompetencë tipike e kreut të shtetit, i cili vepron sipas logjikës së mbrojtjes së interesit të përgjithshëm.[121] Dy pika kontestuese duhen sqaruar në lidhje me këtë paragraf: a) nëse Presidenti i Republikës mund ta shpall gjendjen e jashtëzakonshme edhe pa konsultim me kryeministrin; dhe b) nëse Presidenti i Republikës mund të refuzoj konsultën e kryeministrit sa i përket vendimit për të shpallur gjendjen e jashtëzakonshme. Sa i përket pikës së parë, është absolutisht e qartë që Presidenti është i detyruar të konsultojë kryeministrin sa i përket vendimit për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme. Megjithatë, ky paragraf, sa i përket lidhjes në mes të vendimit të presidentit dhe kërkesës për ”konsultim” me kryeministrin, i referohet konceptit ”konsultim” me kryeministrin thjesht në aspektin e këshillimit dhe jo detyrimit për ”udhëzim” nga ana e kryeministrit. Në këtë kontekst, detyrimi për të konsultuar kryeministrin nënkupton detyrën e presidentit për t’u këshilluar nga kryeministri sa i përket shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, kurse, Presidenti nuk është i lidhur me të dhe vendos për shpalljen apo jo pavarësisht ”këshillës” së kryeministrit. Kjo do të thotë se vendimi për të shpallur gjendjen e jashtëzakonshme është individual, dhe Presidenti nuk është i detyruar të ndjek këshillën e kryeministrit sa i përket kësaj çështjeje. Megjithatë, duhet thënë këtu se në materializimin e kompetencës për të shpallur gjendjen e jashtëzakonshme, Presidenti është i lidhur me kushtet specifike të përcaktuara me **KKos**, në bazë të cilave mund të bëhet shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme. Nëse janë plotësuar ato kushte, ndërkaq, vlerësimin e bën Kuvendi Kosovës, jo shefi shtetit apo shefi ekzekutivit kosovar. Përveç kësaj, Kuvendi bën vlerësimin edhe nëse janë plotësuar kushtet e vëna me **KKos** për zgjatjen e **gjendjes së jashtëzakonshme** pasi të jetë shpallur një herë.

Paragrafi njëzetetre përcakton që Presidenti i Republikës mund të thërras mbledhje të Këshillit të Sigurisë së Kosovës (KSK), dhe i kryeson ato në kohën e gjendjes së jashtëzakonshme. Në kuptim të këtij paragrafi, Presidenti ka të drejt të thërras mbledhjet e KSK-së në çdo kohë, sipas diskrecionit të tij. KSK, në anën tjetër, është i obliguar t’i bindet detyrimit për t’u mbledhur. Kjo kompetencë, megjithatë, nuk nënkupton që Presidenti mund të qeverisë me KSK-në, meqë ky i fundit është një organ kolegjial. Kryesimi i KSK-së në kohën e gjendjes së jashtëzakonshme bëhet nga ana e Presidentit, si një logjikë që ndjek parimin që Presidenti është kreu i shtetit.

Paragrafi njëzetekatër, përcakton kompetencën e Presidentit të Republikës për formimin e misioneve diplomatike e konsullore të Republikës së Kosovës, në bazë të konsultimit me kryeministrin. Koncepti ”konsultim” i shënuar në këtë paragraf nënkupton detyrimin e presidentit për të marrë qëndrimin e kryeministrit sa i përket vendosjes në këtë fushë. Kompetenca për vendosjen në lidhje me formimin e misioneve diplomatike e konsullore të shtetit jashtë vendit shkon në përputhje me kompetencën e përgjithshme të Presidentit të Republikës si udhëheqës i politikës së jashtme të shtetit, të përcaktuar me paragrafin dhjetë të këtij neni.

Paragrafi njëzetepesë përcakton kompetencën e Presidentit të Republikës për të emëruar dhe shkarkuar shefat e misioneve diplomatike të Republikës së Kosovës, me propozimin e qeverisë. Kompetenca për emërim dhe shkarkim, prandaj, është e ndarë mes të Presidentit të Republikës dhe Qeverisë. Në materializimin e kësaj kompetence, Presidenti është i detyruar që të veproj në bazë të propozimit të Qeverisë për kandidatët për emërim apo shkarkim. Presidenti mund t’i refuzoj propozimet e Qeverisë, mirëpo ajo/ai nuk mund të bëj emërime apo shkarkime pa qenë të bazuara

[121] Cf. më shumë për krahasimin me presidentët tjerë në Evropë në një shkrim të Christian Lucky, “A Comparative Chart of Presidential Powers in Eastern Europe“ *East European Constitutional Review.* (Double Issue) Vol. 2 No. 4 (Fall 1993) dhe Vol. 3 No. 1 (Winter 1993), fq. 81-94.

në një propozim të Qeverisë. Emërimi dhe shkarkimi i shefave të misioneve diplomatike të shtetit, si kompetencë e ndarë në mes të presidentit dhe Qeverisë, vendos një lloj balance në kuptim të figurave që bartin këto misione, me nënkuptimin që konsensusi që duhet të ekzistoj në mes të këtyre dy institucioneve prodhon një balancim të vendimit për emërim dhe shkarkim.

Paragrafi njëzetegjashtë përcakton kompetencën e Presidentit të Republikës për të emëruar kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Kjo kompetencë e ndërton një urë përfaqësimi të një kandidati të emëruar nga ana e presidentit në KQZ, duke pasur parasysh që materializimi i kësaj kompetence nga ana e presidentit duhet të bazohet në konceptin e një vendimi neutral që shkon në përputhje me funksionin e tij, si përfaqësues i unitetit të popullit.

Paragrafi njëzeteshtatë përcakton kompetencën e Presidentit të Republikës për të emëruar guvernatorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK). Kjo kompetencë është individuale, dhe i takon vetëm Presidentit të Republikës. Kjo do të thotë se Presidenti është i vetmi autoritet që ka kompetencën për të emëruar guvernatorin e BQK-së. Logjika e funksionit të BQK-së, si një institucion i pavarur, kërkon që materializimi i kësaj kompetence nga ana e Presidentit të Republikës të bëhet në përputhje me funksionin e tij si përfaqësues i unitetit të popullit, duke plotësuar kushtet e renditura në neni 83 të **KKos**. Në këtë drejtim, një rol të rëndësishëm luaj institucioni i konkursit publik dhe i organit drejtues të BQK-së që ekzekuton konkursin për përzgjedhjen e kandidatit për guvernator.

Paragrafët njëzetetetë, njëzetenëntë dhe tridhjetë përcaktojnë tri kompetenca tipike ceremoniale që i takojnë kreut të shtetit. Paragrafi njëzetetetë përcakton kompetencën e Presidentit të Republikës për të dhënë medalje, mirënjohje dhe çmime në pajtim me ligjin e nxjerrë nga Kuvendi.[122] Paragrafi njëzetenëntë përcakton të drejtën e presidentit për falje të të dënuarve, sipas përcaktimit të ligjit përkatës. Në kuptim të kësaj, shembulli i **Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë**, ku përmes vendimit të saj ka vendosur që e drejta për të shpallur faljen apo amnistinë është ekskluzive kompetencë e Presidentit të Republikës, dhe se kjo e drejtë nuk mund të transferohet në asnjë autoritet tjetër shtetëror,[123] është interpretimi që mund të aplikohet edhe në rastin e paragrafit njëzetetetë.[124] Në ushtrimin e kësaj kompetence, si parim, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Afrikës së Jugut, në vendimin CCT 54/09, theksoi se presidenti duhet ta ushtrojë të drejtën e tij për t'i falur të burgosurit në atë mënyrë që të jetë i lidhur racionalisht me objektivat që synohen të arrihen me falje.[125] Kjo është një logjikë interpretuese edhe për paragrafin njëzetenëntë. Paragrafi tridhjetë, ndërkaq, përcakton detyrimin e Presidentit të Republikës për t'iu drejtuar Kuvendit të Kosovës një herë në vit sa i përket fushëveprimtarisë së vet. Detyrimi për t'iu drejtuar me një fjalim vjetor Kuvendit, megjithatë, në kuptim të këtij neni, nuk duhet nënkuptuar si detyrim i presidentit për t'i raportuar apo për t'i dhënë përgjegjësi Kuvendit për punën e tij. Kjo është kështu për shkak se Presidenti nuk bart përgjegjësi politike përballë Kuvendit, dhe është absolutisht i pavarur nga Kuvendi në kryerjen e funksioneve të tij kushtetuese. Kjo nënkupton se fjalimi vjetor në Kuvend i Presidentit të Republikës, sipas këtij paragrafi, ka thjesht një karakter informues.

---

122 Duke tentuar që t'ia ruaj ekskluzivitetin e kësaj kompetence presidenciale, **Gjykata Kushtetuese e Lituanisë** ka vendosur që rregullorja që i siguron Presidiumit të Këshillit Suprem të Republikës së Lituanisë kompetenca sa i përket dhënies së shpërblimeve, është në kundërshtim me dispozitat kushtetuese që përcaktojnë se shpërblimet shtetërore jepen nga Presidenti i Republikës. Cf. **Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë**, Nr. 7/08, i dates 07 korrik 2010.

123 **Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë**, Nr. PL. US 8/97, i datës 24 qershor 1998.

124 Si shembull krahasues, **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Afrikës së Jugut** në vendimin, Nr. CCT 42/09 theksoi se presidenti në ushtrimin e kompetencave kushtetuese për faljen e të burgosurve mund të kërkojë asistencë nga Kabineti qeveritar apo ministritë përkatëse, por përgjegjësia në ushtrimin e kësaj kompetence mbetet vetëm e Presidentit (**Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Afrikës së Jugut)**, Nr. CCT 42/09 i datës 30 korrik 2009.

125 **Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Afrikës së Jugut**, Nr. CCT 54/09, i datës 23 shkurt 2010.

9.3. Kualifikimi, zgjedhja, mandati dhe mbarimi (përfundimi) i mandatit

Neni 85 i **KKos** përcakton kushtet që duhet t'i plotësojë një kandidat që të mund të zgjidhet President i Republikës. Sipas këtij neni, janë dy kushte themelore që duhen plotësuar: a) që kandidati për president të jetë shtetas i shtetësisë së Republikës së Kosovës në momentin e kandidimit; dhe b) që kandidati të ketë mbushur 35 vjet në ditën kur bën betimin si President i Republikës. Sa i përket kushtit të shtetësisë, logjikisht është e pritshme që kandidati të jetë shtetas i Kosovës ditën kur kandidon për president. Ky nen nuk jep kushte shtesë, të tilla që mund të kërkonin që kandidati të ketë jetuar në Kosovë për një kohë të caktuar si shtetas kosovar. **Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë**, në kuptim të interpretimit të një dispozite të ngjashme kushtetuese, ka vendosur që qytetari i lindur bullgar që kandidon për president të Bullgarisë, sipas kushtetutës duhet të ketë fituar shtetësinë bullgare për nga origjina apo vendi i lindjes në datën e lindjes sipas ligjit përkatës bullgar në fuqi.[126]

Fjalia e parë e nenit 85 të **KKos**, që thotë se "President i Republikës së Kosovës mund të zgjidhet çdo shtetas i Republikës së Kosovës" pasohet nga fjalia tjetër që përcakton se kandidati për president duhet të ketë "mbushur moshën tridhjetë e pesë (35) vjeçare". Sikundër shihet, sa i përket kushtit të moshës, mosha 35-vjeçare përmbush një detyrim bazik që Presidenti i Republikës të ketë një maturi themelore në kuptim të moshës.[127] Ky nen, më një paragraf të vetëm, me këto dy fjali, vendos dy kushte shumë themelore, duke promovuar një sistem shumë të hapur mbi konkurruesit. Mungesa e kushteve shtesë, të tilla çfarë kanë shumë kushtetuta në botë, e bën procesin e kandidimit për President të Republikës të krijoj hapësirë për konkurrim të hapur.

Në aktgjykimin e saj mbi **amendamentet kushtetuese**, **GJKRKS** është marrë edhe me çështjen e kushteve për President të Republikës, të cilat segmente të caktuara të politikës kosovare synonin t'i vendosin. Ndër to ka qenë edhe: a) të qenit banor i përhershëm i Republikës së Kosovës për pesë (5) vjet me radhë; dhe b) propozimet për postin e presidentit të Kosovës mund të vijnë vetëm nga subjektet politike parlamentare që kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet e fundit. Lidhur me Kushtin e parë, **GJKRKS** diskutoi dhe vendosi në paragrafët 114-120. Me këtë rast, ajo ka theksuar, ndër të tjera, se në "në shikim të parë mund të duket e arsyeshme të kufizohet mbajtësi i postit me këtë kriter të banimit për të siguruar që presidenti është i lidhur ngushtë me popullin dhe shtetin para se të hyjë në postin më të lartë politik në vend". Mirëpo, ka vazhduar më tej **GJKRKS**, ky formulim cenon të drejtat njerëzore që kanë të bëjnë me barazinë e të gjithëve para ligjit dhe mosdiskriminimin. Sa i kushtit të dytë, **GJKRKS** ka vendosur dhe diskutuar në paragrafët 131-140 të aktgjykimit në fjalë, duke gjetur se kushti i tillë është diskriminues ndaj partive të tjera që pritet të marrin pjesë në garë zgjedhore në mënyrë ligjore.[128]

Neni 86 i **KKos** rregullon çështjen e zgjedhjes së Presidentit të Republikës. Si e tillë ka qenë një ndër çështjet më kontraverse në diskursin politik dhe kushtetues kosovar dhe objekt i njërit prej aktgjykimeve më me rëndësi të **GJKRKS**.[129] Sipas paragrafit të parë të këtij neni, votimi duhet të jetë i fshehtë, kurse sipas të dytit presidenti i ri duhet të zgjidhet tridhjetë ditë para se të skadojë mandati i presidentit në detyrë.

I nominuari për president mund të jetë çdo **shtetas i Kosovës**, pa marrë parasysh nëse ka edhe një shtetësi tjetër, me kusht që të sigurojë nënshkrimet e tridhjetë (30) deputetëve. Kjo nënkupton se në

126 **Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë**, Nr. 12/96, i datës 23 korrik 1996.

127 Kështu ta zëmë, siç tregon një studim, në **SHBA** publiku i jep më shumë rëndësi personalitetit sesa partisë nga e cila vjen kandidati për president. Rol shumë të rëndësishëm në këtë aspekt ka edhe integriteti i kandidatit në kuptim të maturisë së tij. Cf. më shumë në Arthur H. Miller, Martin P. Wattenberg and Oksana Malanchuk, "Schematic Assessments of Presidential Candidates" *The American Political Science Review.* Vol. 80 No. 2, (June 1986), fq. 521-540.

128 Cf. **Rastet K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12**.

129 Cf. **Rasti K.O. 29/11**.

një Kuvend prej 120 deputetëve më së shumti katër kandidatë mund të hyjnë në garë për president. Ky paragraf e jep kuptimin e dy të tjerëve në vijim që flasin për fitimin e dy të tretave (2/3) të votave të të gjithë deputetëve si kusht për t'u zgjedhur president, si dhe për organizmin e votimit të tretë nëse në dy votimet e para asnjëri prej kandidatëve nuk fiton dy të tretat (2/3) e votave të kërkuara. Në votimin e tretë, president zgjidhet kandidati që merr votat e shumicës absolute, d.m.th. gjashtëdhjetë (60) votat e deputetëve të **Kuvendit të Kosovës**. Nëse as në votimin e tretë asnjëri nga kandidatët nuk fiton shumicën absolute të votave, atëherë Kuvendi shpërndahet dhe shkohet në zgjedhje të reja brenda dyzetë e pesë (45) ditëve. Nga kjo rrjedh se për t'u zgjedhur president duhet të plotësohen këto kushte: një, që votimi duhet të jetë me votim të fshehtë; dy, që të ketë më shumë se një kandidat në të gjitha votimet deri në arritjen e dy të tretave (2/3), përkatësisht deri në fitimin e shumicës absolute të votave në Kuvend; tre, që nuk mund të ketë më shumë se katër kandidatë në garë për president; dhe, së fundi, katër, që me rastin e fillimit të votimit për President të Republikës në sallë duhet të jenë prezent numri që kërkohet për t'u bërë president në votimin e parë, pra dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit.

Mosplotësimi i këtyre kushteve e bën zgjedhjen e presidentit të pavlefshme. Këtë e ka konstatuar **GJKRKS** në aktgjykimin e sipërcekur, mirëpo pavlefshmërinë e deklaruar nuk e ka bërë me efekt prapaveprues.[130] Po ta kishte bërë një gjë të tillë, atëherë do të ishin prodhuar dy pasoja: e para, çdo veprim i ndërmarr nga presidenti **Behgjet Pacolli** do të ishte konsideruar si jo i vlefshëm (p.sh. emërimi i ambasadorëve, pranimin i letrave kredenciale, emërimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve, etj.); dhe, e dyta, vendi do të kishte shkuar në zgjedhje brenda dyzetë e pesë (45) ditëve.
Neni 87 i **KKos** e rregullon çështjen e fillimit të mandatit të Presidentit të Republikës, kohëzgjatjen e tij dhe hapësirën për rizgjedhje. Ky nen përcakton që mandati i Presidentit të Republikës fillon në momentin e dhënies së betimit në Kuvendin e Kosovës. Pra, në kuptim të paragrafit të parë të këtij neni, Presidenti e fillon detyrën e tij me dhënien e betimit në Kuvendin e Kosovës. Në kuptim të kësaj, **Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë** pati vendosur që efekti juridik i zgjedhjes së presidentit është **nul** nëse personi i zgjedhur dështon të bëjë betimin siç është paraparë me kushtetutën e këtij vendi.[131] Një interpretim i tillë mund të bëhet edhe në kuptim të paragrafit të parë të nenit 87 të **KKos**.

Sa i përket çështjes së kohëzgjatjes së mandatit, paragrafi i dytë i këtij neni përcakton që kohëzgjatja e mandatit të Presidentit të Republikës është 5 vite. Shikuar nga kjo perspektivë, mandati i Presidentit të Republikës është më i gjatë se mandati kushtetues i Qeverisë dhe Parlamentit. Kjo lejon që mos të ketë përputhje në mes të kohës së zgjedhjes së Presidentit të Republikës dhe kohës së zgjedhjes së Kuvendit dhe Qeverisë, duke nënkuptuar që, parimisht, duhen ndërtuar marrëveshje të veçanta politike për zgjedhjen e presidentit dhe të Kuvendit. Në këtë aspekt, mandati pesëvjeçar (5) i mundëson Presidentit të Republikës që të ketë kohëzgjatje mbi të paktën dy legjislatura dhe Qeveri, duke mundësuar që Presidenti i Republikës të luajë rolin e tij kundërbalancues në mënyrë më efikase. Duhet thënë që, fakti që ky paragraf i jep Presidentit të Republikës mandat pesëvjeçar (5), përderisa Kuvendi dhe Qeveria kanë mandat kushtetues katërvjeçar (4), e rrënjos idenë që mandati i Presidentit të Republikës është i ndarë nga mandati i Kuvendit. Pra, edhe nëse ka një procedurë ku Presidenti zgjidhet nga ana e Kuvendit, shpërndarja e Kuvendi para kohe nuk interferon në kohëzgjatjen e mandatit të Presidentit të Republikës. Këtë interpretim kësisoj, pak a shumë, e ka mbrojtur **GJKRKS** në aktgjykimin e saj mbi **amendamentet kushtetuese**. Më këtë rast, ajo ka theksuar se mandati pesëvjeçar (5) i presidentit nuk mund të ndërpritet para kohe përmes teknikës juridike të amendamentimit kushtetues. Kjo rrugë e eliminimit të Presidentit të Republikës bie ndesh me parimin e sigurisë juridike dhe, mbi të gjitha, cenon postulatin themelor mbi rolin dhe rëndësinë e presidentit si përfaqësues i unitetit juridiko-kushtetues të popullit dhe si garantues i funksionimit normal të institucioneve të sistemit.[132]

130 Cf. **Rasti K.O. 29/11,** paragrafi 15.
131 Cf. **Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë**, Nr. II.US 65/97 i datës 10 dhjetor 1997.
132 Cf. **Rastet K.O.29/12** dhe **K.O. 48/12**, paragrafët 255-271.

U mor vesh, kjo nuk do të thotë se nuk ekziston një mënyrë kushtetuese për ta ndryshuar mandatin e kreut të shtetit. Në aspektin komparativ ka pasur raste kur kjo ka ndodhur, pra kur është ndryshuar mandati i shefit të shtetit, ashtu sikundër që ka kushtetuta që e sanksionojnë një gjë të tillë. Rasti i parë ka ndodhur në **Francë**, në vitin 2000. Atë vit, francezët ndryshuan me **amendament kushtetues** mandatin e presidentit të atëhershëm francez nga 7 (shtatë) në 5 (pesë) vite. Por, ky amendament hyri në fuqi dhe u zbatua vetëm për sa i përkiste presidentit tjetër që vinte, jo atij aktual. Kjo do të thotë se nuk u lejua apriori që amendamenti i ri, që ndryshoi mandatin e presidentit aktual francez, të kishte efekt retroaktiv si në rastin kosovar.[133] Nga kushtetutat që parashohin një gjë të tillë, vlen të theksohet **Kushtetuta e Koresë së Jugut**, e cila përcakton procedurat që duhet ndjekur në rastet kur ndryshohet mandati i kreut të shtetit, duke e bërë të qartë se ato ndryshime mund të vlejnë vetëm për shefin e ardhshëm të shtetit.[134]

Ky nen gjithashtu përcakton që një person mund të ushtroj vetëm dy mandate postin e Presidentit të Republikës. Pra, maksimumi i kohës për të cilën një person mund të ushtrojë detyrën e Presidentit të Republikës është dhjetë (10) vite. Shikuar nga ky aspekt, kufizimi i të drejtës për rikandidim vetëm një herë, shihet si një kusht publik i kufizimit të mandatit të institucioneve, me qëllim që të parandalohen qeverisjet monopoliste pa kufizim kohor. Një shembull interesant i **Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë**, që ka interpretuar kufizimin e mandateve apo ndalimin e më shumë se dy mandateve, të paraparë me Kushtetutën e vitit 1990 (pra në regjimin kushtetues paraprak), si diçka që nuk mund të zbatohet për mandatet e kaluara të bazuara në ligjet para hyrjes në fuqi të Kushtetutës aktuale.[135] Një interpretim i tillë mund të thuhet që ka hapësirë aplikimi edhe në rastin e kësaj norme kushtetuese në Kosovë, në veçanti nëse kihet parasysh synimi i sipërcekur me amendamentet kushtetuese: **draft amendamenti kushtetues dhjetë** (X), në paragrafin e tretë theksonte se "presidentët që kanë shërbyer para hyrjes në fuqi të këtyre amendamenteve, kanë të drejt të zgjidhen dhe rizgjidhen edhe një herë si President i Republikës së Kosovës". Më këtë dispozitë nuk numërohet si mandat koha e mandatit të parë të ish-presidentëve të Kosovës që janë zgjedhur para deklarimit të pavarësisë më 17 shkurt 2008. Kjo paraqet diskriminim karshi atyre që do të jenë president në të ardhmen, sepse disa do të kenë të drejtën e shërbimit si president republike një përkatësisht dy mandate më shumë. Kjo është kështu për dy arsye: arsyeja e parë ka të bëjë me kontinuitetin institucional, kurse e dyta i referohet garantimit të funksionimit dhe stabilitetit të institucioneve. Thënë shkurt, kjo dispozitë e propozuar me amendamentin dhjetë (X), synonte vënien në pozitë të pabarabartë të gjithë kandidatëve të tjerë dhe presidentët e mundshëm kundrejt atyre që kanë shërbyer një herë, duke mos ua llogaritur këtyre të fundit mandatin e parë të ushtruar si President Republike.[136]

9.4. Papajtueshmëria

Neni 88 i **KKos** e rregullon çështjen e **papajtueshmërisë** së detyrës së presidentit me ndonjë detyrë tjetër. Si parim, ky nen ka zbatueshmëri dhe relevancë vetëm prej momentit kur Presidenti i Republikës e fillon ushtrimin e mandatit të tij. Ky nen, në anën tjetër, duhet shikuar ngushtësisht me parimin që Presidenti është përfaqësues i unitetit të popullit, i sanksionuar me nenin 83 të KKos. Shkurtimisht, ky nen vendos ndalesën që Presidenti të ushtrojë çfarëdo funksioni publik apo funksion partiak, e cila është në përputhje me konceptin e ndarjes së pushteteve dhe rolin e presidentit si garantues dhe balancues i

133 Oliver Duhamel, "France's New Five - Year Presidential Term". *BROOKINGS*, 1 March 2001. Në internet: http://www.brookings.edu/research/articles/2001/03/france-duhamel (herën e fundit shikuar nëntor 2022).

134 **Kushtetuta e Koresë së Jugut** e 17 korrikut 1948, në nenin 128, iniciativa për ndryshim të saj, përcakton se "[…] Amendamentet në Kushtetutë për zgjatje të kohës së mandatit të Presidentit apo për lejimin e rizgjedhjes së tij nuk mund të hyjnë në fuqi për Presidentin në detyrë në kohën e parashtrimit të tyre". **Komisioni i Venedikut** këtë dispozitë e konsideron si një standard të mire dhe si masë matëse për vlerësim të **kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese që prekin mandatet e organeve kryesore të shtetit**. Cf. Report on Constitutional Amendment, adopted by the Venice Commission at its Plenary Session, Venice, 11-12 December 2009, paragrafi 145.

135 **Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë**, Nr. U-VII-700/1997 i datës 11 qershor 1997.

136 Cf. **Rastet K.O.29/12** dhe **K.O. 48/12**, paragrafi 273.

funksionimit normal të institucioneve të sistemit kushtetues.[137] Në anën tjetër, ky nen pengon hyrjen e Presidentit në konflikt interesi me funksionin e tij, sipas nenit 83. Sipas interpretimit të rastit **Rrustemi et al v. Presidenti i Republikës**, koncepti ”ushtroj” i përcaktuar nga ky nen nënkupton edhe ”mbajtjen” pasive të një posti nga ana e presidentit. Thënë kjo, mjafton që presidenti të mbaj një post tjetër publik apo partiak, dhe që të mos e ushtroj atë aktivisht, që ajo/ai të konsiderohet se po shkel detyrimin që vjen nga ky nen.[138] Ndalesat e vendosura me nenin 88 i shërbejnë idesë së një presidenti republike që përmbush funksionin e një përfaqësuesi të unitetit të popullit. Logjika themelore në këtë aspekt është që bartja e çfarëdo funksioni tjetër publik apo partiak nga ana e Presidentit të Republikës është në kundërshtim me detyrën e tij që t’i shërbejë përfaqësimit të unitetit të popullit. Ky nen e përmbyll qarkun e përcaktimit që Presidenti të ushtroj vetëm detyrën e tij, dhe të mos bëj pjesë në institucione apo rryma/parti politike që e sjellin atë në konflikt me detyrimin sipas nenit 83 të **KKos**.[139]

9.5. Imuniteti

Neni 89 i **KKos** rregullon çështjen e imunitetit të Presidentit të Republikës. Sipas këtij neni, Presidenti i Republikës gëzon imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimet dhe vendimet brenda funksionit të tij si president republike. Imuniteti i dhënë me këtë nen është i tipit **funksional**, pra, imunizon Presidentin e Republikës vetëm në kuadër të kryerjes së funksionit të vet. Veprimet e Presidentit të Republikës jashtë funksionit të tij kushtetues nuk mbrohen nga imuniteti i dhënë me këtë nen. Imuniteti, sa i përket ushtrimit të funksionit, nuk është vetëm në fushën penale, por edhe në atë civile (sipas modelit të rastit **Nixon v. Fitzgerald***)*,[140] dhe të përgjegjësisë politike. Presidenti, prandaj, as nuk mundet të shkarkohet e as të paditet, por as të ndiqet penalisht për veprimet dhe vendimet e marra në vijim të kryerjes së funksionit të tij. Koncepti ”veprim dhe vendim” i presidentit, natyrisht, përfshin edhe rastet kur Presidenti i Republikës ”nuk vepron”. Pra, nëse ka shmangie nga një veprim që është dashur të ndërmerret, Presidenti është sërish i mbrojtur me këtë nen të **KKos**.

Çështja më e vështirë në interpretimin e këtij neni është shënjimi i kufirit mes asaj që konsiderohet veprim në kuadër të funksionit të presidentit dhe veprim jashtë këtij funksioni. Për t’u kualifikuar si juridikisht i mbrojtur nga çfarëdo procedure gjyqësore, përfshirë shkarkimin, fillimisht duhet të vlerësohet nëse një veprim i Presidentit të Republikës hyn në çadrën e funksionit të tij kushtetues. Ky vlerësim, sipas një logjike institucionale, duhet të marrë parasysh këta **tre tregues**: a) nëse veprimi ose lëshimi i Presidentit të Republikës është bërë me bazë në një kompetencë kushtetuese; b) nëse veprimi ose lëshimi i bërë nga Presidenti i Republikës, pavarësisht nëse bazohet në një kompetencë eksplicite kushtetuese, është në përputhje me funksionin e Presidentit të Republikës sipas nenit 83 të KKos; dhe c) nëse veprimi ose lëshimi i Presidentit të Republikës ka tejkaluar në mënyrë të arsyeshme kufijtë institucionalë të vendimmarrjes dhe pushtetit të përcaktuar me **KKos**. Kalimi me sukses i këtij testi, bazuar në këta tregues, e bën veprimin ose lëshimin e Presidentit të Republikës të imunizuar nga ndjekja penale, padia civile ose shkarkimi në kuptim të këtij neni.

---

137 Cf. Steven G. Calabresi and Joan L. Larsen, “One Person One Office: Separation of Powers or Separation of Personnel” *Cornell Law Review.* Vol. 79 Issue 5 (July 1994), fq. 1045-1057; Cf. edhe në Harold H. Bruff, H., Harold, “The Incompatibility Principle“. *Administrative Law Review*. Vol. 59 No. 2 (Spring 2007), fq. 225-268 (sa i përket parimit të ndarjes së pushtetit në kuptim të ndalesave sikur në këtë nenin 88 të **KKos**).

138 Cf. Aktgjykim: **Rasti Nr. KI 47/10**, paragrafët 63-70.

139 Si shembull gjyqësor krahasues, **Gjykata Kushtetuese e Moldavisë** në vendimin e saj 1/2008 theksoi se në bazë të kushtetutës, posti i presidentit të republikës është në papajtueshmëri me anëtarësinë në një parti politike apo ndonjë organizim politik përgjatë mandatit të Presidentit. Cf. **Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Moldavisë**, Nr. 1/2008 i datës 3 prill 2008.

140 Cf. një kritikë mbi gjerësinë **e imunitetit civil** për presidentin e SHBA, të ngjashëm me nenin 89 të **KKos**, në Aviva A. Orenstein, “Presidential Immunity from Civil Liability:Nixon v. Fitzgerald” *Cornell Law Review*. Vol. 68 No. 2 (January 1983), fq. 236-256.

Interpretimi i ngushtë i imunitetit shihet nga dijetarët e fushës si përparësi, meqë nuk lejon që Presidenti të vendoset mbi ligjin. Këtu nuk ka rëndësi nëse është fjala për sistem presidencial, të përzier (gjsmëpresidencial) ose parlamentar të pushtetit: përparësia është një privilegj që e gëzon shefi shtetit, e cila nuk e vë atë mbi ligjin.[141] Kufizimi imunitetit të presidentit dhe dhënia e hapësirës për kontroll gjyqësor të funksionit të tij shihet me vlerësim pozitiv nga autorët e fushës.[142] Studiuesit kanë argumentuar se veprimet dhe lëshimet e Presidentit të Republikës gjatë kryerjes së funksionit të tij, që vlejnë edhe për interpretimin e nenit 89 të **KKos**, nuk duhet lejuar të imunizohen nëse shkelin norma e të drejtës ndërkombëtare.[143] Kjo çështje u bë aktuale në veçanti pas luftës në ish-**Jugosllavi** (1991-1999), e cila shtroi nevojën e ndjekjes dhe ndëshkimit të zyrtarëve të lartë. Gjykata e Hagës për Krimet e Kryera në Ish-Jugosllavi (ICTY), e njohur si **Gjykata e Hagës për Ish-Jugosllavi**, u themelua në muajin maj 1993 dhe akuzoi e gjykoi disa funksionarë të lartë shtetërorë në ish-Jugosllavi. Praktika e ndjekur nga kjo gjykatë, në esencë ka ndjekur standardin e **Gjykatës së Nyrembergut** (1945-1946), e cila nuk njohu asnjë lloj imuniteti shefave të shteteve dhe zyrtarëve të lartë shtetërorë për krimet kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare, si dhe për krimet tjera që cenojnë normat **jus cogens** të së drejtës ndërkombëtare. Në vijim të kësaj, vlen të theksohet këtu se nenet 16.3 dhe 19.2 të **KKos** faktojnë këtë konstatim: neni 16.3 thotë se "Republika e Kosovës respekton të drejtën ndërkombëtare", kurse për epërsinë e normave **jus cogens** në rendin ligjor dhe kushtetues kosovar flet neni 19.2 si më sipër.

Në kuptim të këtij neni, kohëzgjatja e imunitetit funksional për Presidentin e Republikës vazhdon edhe pas përfundimit të mandatit të tij: veprimet/lëshimet e bëra gjatë kohës sa ka kryer funksionin e tij mbesin të imunizuara.[144] Këtë e konfirmon edhe jurisprudenca e **GJKRKS**, e cila ka ndjekur këto vija arsyetimi në rastin e njohur të **imuniteteve të funksionarëve të lartë shtetërorë të Republikës së Kosovës**.[145]

9.6. Mungesa e përkohshme e presidentit

Neni 90 i **KKos** rregullon çështjen e mungesës së përkohshme të Presidentit të Republikës për shkak të paaftësisë së saj/tij, si dhe procedurën konstatimit të paaftësisë së saj/tij. Janë dy lloje të procedurave që mund të ndodhin, sipas përcaktimit të këtij neni, sa i përket paaftësisë së ushtrimit të funksionit të Presidentit të Republikës. Së pari, nëse Presidenti, për shkak të paaftësisë së saj/tij, vendos vet që vullnetarisht t'ia kaloj detyrën kryetarit të Kuvendit të Kosovës, i cili mund ta ushtroj detyrën e tillë për gjashtë (6) muajt në vijim.[146] Me rastin e kalimit të detyrës tek Kryetari i Kuvendit, Presidenti duhet të jap arsyet për një vendimin e tillë. Postin e ushtruesit të detyrës, kryetari i Kuvendit mund ta ushtroj më së shumti për gjashtë muaj. Nëse edhe pas gjashtë (6) muajsh Presidenti nuk e rimerr detyrën, atëherë duhet të konsiderohet që mandati i saj/tij ka përfunduar dhe të shpallen zgjedhjet për president të ri. Së dyti, Kuvendi i Kosovës, për shkak të paaftësisë së presidentit (këtu, ky nen i referohet paaftësisë mjekësore, qoftë fizike apo mendore), në bazë të një vendimi kredibil nga ana e një kolegji mjekësor, me dy të tretat e votave të të gjithë deputetëve, vendos mbi bartjen e ushtrimit të funksionit të Presidentit të Republikës te Kryetari i

---

141 Cf. lidhur me këtë një kritikë, bazuar mbi këtë argument, në shkrimin e Akhil Reed Amar and Neal Kumar Katyal, "Executive Privileges and Immunities: The Nixon and Clinton Cases" *Harvard Law Review.* Vol. 108 No. 3 (January 1990), fq. 701-726.

142 Cf. Jennifer L. Long, "How to Sue the President: A Proposal for Legislation Establishing the Extent of Presidential Immunity" *Valpo University Law Review* Vol 30 No. 1 (Fall 1995), fq. 283-333.

143 Cf. Michael J. Glennon, "Can the President Do No Wrong?" *The American Journal of International Law*, Vol. 80 No. 4 (October 1986), fq. 923-930.

144 Lidhur me problemet që lindin nga kjo, cf. Peter Evan Bass, "Ex-Head of State Immunity: A Proposed Statutory Tool of Foreign Policy" *The Yale Law Journal* Vol. 97 No. 2 (December 1987), fq. 299-319.

145 Cf. Aktgjykimi për rastin **KO 98/11**.

146 Në një shembull të tillë, **Gjykata Kushtetuese e Portugalisë** ka vendosur që kur vetë presidenti kërkon të deklarohet përkohësisht i paaftë për t'i ushtruar detyrat e saj/tij, atëherë nuk ka nevojë që ajo të thërrasë seancë dëgjimore dhe as të kërkojë vërtetime mjekësore për të provuar paaftësinë e vetëdeklaruar të presidentit të republikës, siç parashikohet me nenin 88 të **Ligjit nr.28/82**. Cf. **Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Portugalisë**, Nr.976/96 i datës 27 korrik 1996.

Kuvendit. Sikur edhe në rastin e parë, nëse brenda gjashtë (6) muajsh gjendja fizike/mendore e presidentit të republikës nuk ndryshon, në bazë të konstatimit të kolegjit mjekësor, atëherë përfundon mandati i presidentit dhe shpallen zgjedhjet për presidentin e ri.

Sa i përket garancionit prej dy të tretave (2/3) të votave të të gjithë deputetëve, ky është një prag që mëton të garantoj që vendimi i Kuvendit mbi transferimin e detyrës së Presidentit të Republikës të jetë konsensual në kuptimin partiak, do të thotë që të ketë një shumicë më të gjerë se sa mazhoranca parlamentare. Sa i përket kuptimit të vendimit të këtij neni, nëse Presidenti konsideron që vendimi i kolegjit mjekësor dhe rrjedhimisht vendimi i Kuvendit për t'ia marr detyrën përkohësisht kanë qenë të manipuluar, atëherë ajo/ai ka të drejt që vendimin e tillë të Kuvendit ta dërgojë për kontroll të kushtetutshmërisë në **GJKRKS**.

9.7. Shkarkimi presidentit

Neni 91 i **KKos** shtjellon çështjen e shkarkimit të Presidentit të Republikës. Ky nen mëton të rregulloj edhe anën procedurale edhe atë materiale të shkarkimit të Presidentit të Republikës. Paragrafi i parë i këtij neni flet për anën materiale të shkarkimit, pra për arsyet që mund të çojnë deri të shkarkimi, kurse dy paragrafët tjerë e rregullojnë anën procedurale të shkarkimit.

Paragrafi i parë flet për shkarkimin e presidentit në rastet kur ai/ajo kryen **vepër të rëndë penale**, mirëpo në praktikë vështirë se mund të imagjinohet një situatë e tillë ku presidenti të ngelë në detyrë përkundër që ka konsumuar ndonjë vepër "të lehtë" (jo të rëndë) penale. Cilado që mund të jetë natyra e veprës penale, presidenti do të duhej të shkarkohej nga Kuvendi, nëse ajo/ai vetë nuk do të jepte **dorëheqje**. Kjo e fundit, çuditërisht, nuk parashihet teknikisht në **KKos**. Kjo në asnjë mënyrë nuk nënkupton se **dorëheqja** përjashtohet si mënyrë e përfundimit të mandatit të Presidentit të Republikës, nisur nga natyra krejt e vetëkuptueshme e aktit të dorëheqjes. Sa i përket bazës tjetër për shkarkim, asaj të paaftësisë për të kryer detyrat dhe për të ushtruar përgjegjësitë për shkak të sëmundjes së rëndë, vlejnë të njëjtat argumente, **mutatis mutandis**, të dhëna me nenin 90 të **KKos**, si më sipër.

Paragrafi i dytë flet për **peticionin** për shkarkim. Edhe këtu, kur flitet për shkaqet e sëmundjes së rëndë si bazë për nisje të peticionit. Por, peticioni mund të paraqitet edhe për shkaqe të tjera objektive. Edhe këtu vlejnë argumentet e njëjta, **mutatis mutandis**, si ato të dhëna për paragrafin e mësipërm të këtij neni. Ndryshe qëndron puna kur si bazë për shkarkim **shërben shkelja e rëndë e pohuar** e **KKos**. Këtu kemi të bëjmë me situatat e cenimit të rëndë të KKos, të cilat janë të hapura, momentale dhe brutale. Për këto situata, KKos rregullon si anën **materiale** ashtu edhe anën **procedurale** që duhen ndjekur për konstatimin nëse ka ardhur deri te ndonjë cenim i rëndë i KKos nga shefi shtetit. **GJKRKS** ia cakton një afat tepër të shkurtër për vendimmarrje, afatin shtatëditor (7) nga dita e marrjes së peticionit. Kjo është arsyeja që e dallon këtë bazë për shkarkim nga ajo e paraparë në kuadër të dispozitave që flasin për juridiksionin e **GJKRKS**, në nenin 113.6 të KKos. Për këtë bazë të shkarkimit në kuadër të juridiksionin do të flitet më vonë. Këtu mjafton të thuhet se ky paragraf i nenit 91 flet për **shkelje të rënda**, kurse në nenin 113.6 të KKos është përdorur fjala **shkelje serioze** të KKos. Këto shprehje kanë edhe pasojat e tyre të cilat dallojnë esencialisht nga njëra tjetra. Ky dallim në rend të parë reflektohet në afatin tepër të shkurtër, shtatëditor (7), të paraparë për nisjen e peticionit kur flitet për **shkeljet e rënda** të KKos. Ky nuk është rasti me **shkeljet serioze** nga neni 113.6 i KKos.

Përveç kësaj, numri i deputetëve që kërkohet në rastin e parë është më i madh se në rastin e dytë, gjë që flet për një dallim tjetër thelbësor. Mirëpo, dallimi krejt esencial nuk qëndron te procedurat, por te përmbajtja e dy fjalëve të përdorua. Siç është parë edhe nga rasti i ish-Presidentit të Republikës, zt. **Fatmir Sejdiu**, te **cenimet serioze** të KKos, më shumë bëhet fjalë për veprime joserioze dhe të pallogaritura mirë të shefit të shtetit, të cilat lidhen me natyrën dhe pozitën e shefit të shtetit siç përcaktohet me nenet 4.3 ["Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit"] dhe 83 ["Statusi i Presidentit"] të KKos. Në rastin e dytë, ndërkaq, fjala është më shumë për cenimet e rënda të llogaritura mirë të KKos nga ana e presidentit, që kanë të

bëjnë, kryesisht me veprimet **ultra vires** (siç është, ta zëmë, nënshkrimi apo hyrja në një marrëveshje ndërkombëtare që cenon sovranitetin dhe tërësinë territoriale të vendit). Në këto **shkelje të rënda** hyjnë edhe mosveprimet apo tolerimet nga ana e Presidentit të Republikës të situatave të caktuara me të cilat cenohet rendi kushtetues kosovar (siç është, ta zëmë, mosveprimi ndaj, apo tolerimi, i kaosit në vend në situatat e gjendjes së jashtëzakonshme, pa marrë parasysh si janë shkaktuar gjendjet e tilla të jashtëzakonshme). Nga kjo që u tha deri këtu, del se **cenimet serioze** mund të jenë veprime të pavërejtshme për laikët dhe mund të zgjasin e të përbëhen nga disa veprime zinxhirore, në ndërkohë që **cenimet e rënda** paraqesin veprime, apo mosveprime (tolerime) të momentit, brutale dhe të hapura të cilat ndërmerren (apo tolerohen) jo për të kompromet uar rolin dhe pozitën e shefit të shtetit por për të rrënuar ose rrezikuar rendin kushtetues si tërësi.[147]

10. Presidenti i Shqipërisë

Nenet 86-94 të pjesës së katërt të **KShq** rregullojnë rolin dhe pozitën kushtetuese të Presidentit të Republikës. Presidenti i Republikës është kryetar i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit (neni 86.1 i **KShq**). President mund të zgjidhet vetëm shtetasi shqiptar që nga lindja, me qëndrim jo më pak se 10 vjetët e fundit në Shqipëri dhe që ka mbushur moshën 40 vjeçare (neni 86.2 i **KShq**). Kandidati për President i propozohet Kuvendit nga një grup prej jo më pak se 20 deputetësh. Një deputet nuk lejohet të propozojë në të njëjtën kohë më shumë se një kandidat (neni 87.1 i **KShq**). Presidenti i Republikës zgjidhet me votim të fshehtë dhe pa debat nga Kuvendi. Për zgjedhjen e presidentit, Kuvendi zhvillon deri në pesë votime. Votimi i parë zhvillohet jo më vonë se shtatë ditë nga fillimi i procedurës për zgjedhjen e presidentit. Secili nga votimet e tjera zhvillohet jo më vonë se shtatë ditë nga përfundimi pa sukses i votimit pararendës. Votimi quhet i kryer edhe kur në konkurrim nuk paraqitet asnjë kandidat. Në votimin e dytë, të tretë dhe të katërt mund të paraqiten kandidatë të rinj, sipas kushteve të pikës 1 të këtij neni (neni 87.2 i **KShq**). Presidenti zgjidhet në votimin e parë, të dytë ose të tretë kur një kandidat merr jo më pak se tri të pestat e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në votimin e katërt dhe të pestë zgjidhet president kandidati që siguron më shumë se gjysmën e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit (neni 87.3 i **KShq**). Votimi i pestë zhvillohet kur në votimin e katërt asnjë kandidat nuk ka siguruar shumicën e kërkuar të votave. Votimi i pestë zhvillohet vetëm midis dy kandidatëve që kanë marrë më shumë vota në votimin e katërt. Në rast se ka më shumë se dy kandidatë me të njëjtin numër votash, kandidati që merr pjesë në votim caktohet me short. Në rast se pas votimit të katërt nuk ka mbetur asnjë kandidat në konkurrim, për këtë votim mund të paraqiten kandidatë të rinj, sipas kushteve të pikës 1 të këtij neni. Kur paraqiten më shumë se dy kandidatë, votimi zhvillohet midis dy kandidatëve që kanë siguruar numrin më të lartë të deputetëve propozues (neni 87.4 i **KShq**). Në rast se edhe pas votimit të pestë asnjë kandidat nuk siguron shumicën e kërkuar, ose kur pas votimit të katërt pa sukses nuk paraqitet asnjë kandidaturë e re, Kuvendi shpërndahet. Zgjedhjet e reja zhvillohen brenda 45 ditëve nga shpërndarja e tij (neni 87.5 i KShq). Kuvendi pasardhës e zgjedh Presidentin e Republikës me shumicën e të gjithë anëtarëve të tij (neni 87.6 i KShq).

Presidenti i Republikës, në çdo rast, zgjidhet për 5 vjet, me të drejt rizgjedhjeje vetëm një herë (neni 88.1 i KShq). Mandati përfundon në të njëjtën datë të të njëjtit muaj të vitit të pestë nga data e betimit si President i Republikës. Mandati i presidentit zgjatet vetëm në kohë lufte dhe për aq kohë sa vazhdon ajo (neni 88.2 i **KShq**). Kësaj dispozite iu është shtuar edhe paragrafi 2/1 që përcakton se procedura për zgjedhjen e presidentit fillon jo më vonë se 60 ditë para mbarimit të mandatit presidencial paraardhës. Kur mandati

[147] Si shembull gjyqësor, **Gjykata Kushtetuese e Lituanisë**, në vendimin e saj Nr. 24/04, duke elaboruar kushtet për kandidimin për president të republikës, theksoi se, sipas Kushtetutës, kur një person ka shkelur rëndë Kushtetutën, ka shkelur betimin apo ka kryer një vepër penale përmes së cilës ka shkelur rëndë Kushtetutën ose është shkelur betimi i dhënë, dhe ai person është shkarkuar - në përputhje me procedurat e shkarkimit (**impeachment**) - nga pozita e presidentit të republikës, kryetarit apo gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, kryetarit apo gjyqtarit të Gjykatës Supreme, kryetarit apo gjyqtarit të Gjykatës së Apelit, ose i është revokuar mandati parlamentar, ai person nuk mund të zgjidhet kurrë president i republikës, anëtar i parlamentit dhe nuk mund të mbajë kurrë një pozitë të gjyqtarit në Gjykate Kushtetuese, Gjykatë Supreme apo Gjykatë të Apelit, anëtar të qeverisë apo auditor shtetëror. Cf. **Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë**, Nr. 24/04, datë 25.5.2004.

presidencial përfundon në gjashtë muajt që i paraprijnë fundit të mandatit të Kuvendit ekzistues, procedura për zgjedhjen e presidentit fillon jo më vonë se 60 ditë para mbarimit të mandatit të Kuvendit. Presidenti që jep dorëheqjen para mbarimit të mandatit të vet, nuk mund të kandidojë në zgjedhjet presidenciale që bëhet pas dorëheqjes së tij (neni 88.4 i **KShq**).

Presidenti fillon në detyrë pasi bën betimin para Kuvendit, por jo më parë se të ketë mbaruar mandati i presidentit që largohet. Presidenti bën këtë betim: "Betohem se do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve të vendit, do të respektoj të drejtat dhe liritë e shtetasve, do të mbroj pavarësinë e Republikës së Shqipërisë dhe do t'i shërbej interesit të përgjithshëm dhe përparimit të Popullit Shqiptar". Presidenti mund të shtojë edhe: "Zoti më ndihmoftë!" (neni 88.3 i **KShq).** Presidenti nuk mund të mbajë asnjë detyrë tjetër publike, nuk mund të jetë anëtar partie dhe as të kryejë veprimtari tjetër private (neni 89). Neni në vijim, neni 90, në tre paragrafë përcakton çështjen e imunitetit dhe procedurën e shkarkimit, e cila është e ngjashme me disa vende evropiane, ku i jepet një rol vendimtar gardianit të kushtetutës në konstatimin e fajësisë. Presidenti nuk ka përgjegjësi për aktet e kryera në ushtrim të detyrës së tij (neni 90.1 i **KShq**). Ajo/ai mund të shkarkohet për shkelje të rëndë të **KShq** dhe për kryerjen e një krimi të rëndë. Propozimi për shkarkimin në këto raste mund të bëhet nga jo më pak se një e katërta e anëtarëve të Kuvendit dhe duhet të mbështetet nga jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij (neni 90.2 i KShq). Vendimi i Kuvendit i dërgohet Gjykatës Kushtetuese, e cila, kur vërteton fajësinë e presidentit, deklaron shkarkimin e tij nga detyra (neni 90.3 i **KShq**).

Kur Presidenti i Republikës është në pamundësi të përkohshme për të ushtruar funksionet e tij ose kur vendi i tij mbetet vakant, kryetari i Kuvendit zë vendin dhe ushtron kompetencat e tij (neni 91.1 i **KShq**). Në rast se presidenti nuk mund të ushtrojë detyrën për më shumë se 60 ditë, Kuvendi, me dy të tretat e të gjithë anëtarëve, vendos dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese (GJKSH), e cila vërteton përfundimisht faktin e pamundësisë. Në rast të vërtetimit të pamundësisë, vendi i presidentit mbetet vakant dhe zgjedhja e presidentit të ri fillon brenda 10 ditëve nga dita e vërtetimit të pamundësisë (neni 91.2 i **KShq**). Neni 92 normon kompetencat e presidentit, që reflektojnë fizionominë e këtij organi të përcaktuar me nenin 86.1 të **KShq**. Presidenti ushtron edhe këto kompetenca: a) i drejton mesazhe Kuvendit; b) ushtron të drejtën e faljes sipas ligjit; c) jep shtetësinë shqiptare dhe lejon lënien e saj sipas ligjit; ç) jep dekorata e tituj nderi sipas ligjit; d) jep gradat më të larta ushtarake sipas ligjit; dh) me propozim të kryeministrit, emëron dhe liron përfaqësuesit e plotfuqishëm të Republikës së Shqipërisë në shtetet e tjera dhe në organizatat ndërkombëtare; e) pranon letrat kredenciale dhe tërheqjen e përfaqësuesve diplomatikë të shteteve të tjera dhe të organizatave ndërkombëtare të akredituara në Republikën e Shqipërisë; ë) lidh marrëveshje ndërkombëtare sipas ligjit; f) me propozim të kryeministrit, emëron drejtorin e Shërbimit Informativ të Shtetit; g) emëron Kryetarin e Akademisë së Shkencave dhe rektorët e universiteteve sipas ligjit; gj) cakton datën e zgjedhjeve për Kuvendin, për organet e pushtetit vendor dhe për zhvillimin e referendumeve; h) kërkon mendim dhe të dhëna me shkrim nga drejtuesit e institucioneve shtetërore për çështje që kanë të bëjnë me detyrat e tyre. Presidenti i Republikës, në zbatim të kompetencave si më sipër, nxjerr dekrete (neni 93). Së fundi, në nenin 94 të **KShq** definohet papajtueshmëria (konflikti i interesit) në ushtrim të funksionit të Presidentit të Republikës dhe funksioneve dhe punëve të tjera në shoqëri: Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera përveç atyre që i njihen shprehimisht me Kushtetutë dhe që i jepen me ligje të nxjerra në pajtim me të.

11. Presidenti i Maqedonisë së Veriut

Në kapitullin e dytë të pjesës së tretë (nenet 79-87) të KMVe normohet roli dhe pozita kushtetuese e Presidentit të Republikës.

Që në paragrafin e parë të nenit 79 definohet pozita dhe roli kushtetues i shefit të shtetit të këtij vendi fqinj: Presidenti përfaqëson Republikën e Maqedonisë së Veriut (neni 79.1 i **KMVe**) dhe është komandant suprem i forcave të armatosura të Maqedonisë (neni 79.2 i **KMVe)**. Presidenti i Republikës të drejtat dhe

detyrat e veta i ushtron në bazë dhe në kuadër të **KMVe** dhe ligjeve (neni 79.3 i **KMVe**). Nuk ka rëndësi që zgjidhet në zgjedhje të përgjithshme dhe të drejtpërdrejta, me votim të fshehtë, për periudhë kohore prej pesë vitesh (neni 80.1 i **KMVe**): Presidenti Maqedonisë së Veriut nuk ka rolin dhe pozitën kushtetuese të kreut të ekzekutivit. Për President të Republikës personi i njëjtë mund të zgjidhet më së shumti dy herë (neni 80.2 i **KMVe**) dhe doemos duhet të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut (neni 80.3 i **KMVe**). President mund të zgjidhet personi i cili në ditën e zgjedhjeve ka mbushur më së paku 40 vjet moshë (neni 80.4 i **KMVe**). Për President të Republikës nuk mund të zgjidhet personi i cili deri në ditën e zgjedhjeve nuk ka qenë banor i Republikës së Maqedonisë së paku dhjetë vjet në 15 vitet e fundit (neni 80.5 **i KMVe**).

Neni në vijim, neni 81 i **KMVe** normon procedurën e zgjedhjes së Presidentit të Maqedonisë së Veriut. Kandidat për President të Republikës mund të propozojnë së paku 10.000 zgjedhës ose së paku 30 deputetë (neni 81.1 i **KMVe**). Për President të Republikës është zgjedhur kandidati i cili ka fituar shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve (neni 81.2 i **KMVe**). Nëse në rrethin e parë asnjë kandidat për President nuk e ka fituar shumicën e nevojshme të votave, në rrethin e dytë votohet për dy kandidatët të cilët në rrethin e parë kanë fituar më së shumti vota (neni 81.3 i **KMVe**). Rrethi i dytë i votimit mbahet brenda afatit prej 14 ditësh nga përfundimi i rrethit të parë të votimit (neni 81.4 i **KMVe**). Në versionin fillestar të paragrafit të pestë të këtij neni ka qenë e përcaktuar që për president është zgjedhur kandidati i cili ka fituar shumicën e votave të zgjedhësve të cilët kanë votuar, në qoftë se kanë votuar më shumë se gjysma e zgjedhësve. Kjo tani ka pësuar ndryshime, me amendamentin XXXI të datës 9 janar 2009, i cili ka zëvendësuar nenin 81.5 të **KMVe**, dhe i cili thotë se "për President konsiderohet se është zgjedhur kandidati që ka fituar shumicën e votave të zgjedhësve që kanë votuar, nëse kanë votuar më shumë se 40% të zgjedhësve". Në qoftë se edhe në rrethin e dytë të votimit asnjëri nga kandidatët nuk e ka fituar shumicën e nevojshme të votave, përsëritet e tërë procedura zgjedhore (neni 81.6 i **KMVe**). Nëse për President të Republikës është propozuar një kandidat, ndërsa në rrethin e parë të votimit nuk e ka fituar shumicën e nevojshme të votave, përsëritet e tërë procedura zgjedhore (neni 81. 7 i **KMVe**). Zgjedhja e Presidentit të Republikës bëhet në 60 ditët e fundit të mandatit të presidentit të mëparshëm. Në rast të pushimit të mandatit të Presidentit të Republikës nga cilat do qoftë shkaqe, zgjedhja e presidentit të ri bëhet brenda afatit prej 40 ditësh nga dita e pushimit të mandatit (neni 81.8 i **KMVe**). Para marrjes së detyrës, Presidenti i Republikës bën deklaratë solemne para Kuvendit me të cilën obligohet në respektimin e **KMVe** dhe ligjeve.

Neni 82 i **KMVe** rregullon situatat vdekjes, dorëheqjes, pamundësisë së përhershme që ta ushtroj funksionin ose pushimit të mandatit **per constitutionem**. Në raste të tilla, deri në zgjedhjen e Presidentit të ri të Republikës, funksionin e Presidentit të Republikës e ushtron Kryetari i Kuvendit (neni 82.1 i KMVe). Ekzistimin e kushteve për pushimin e funksionit të Presidentit të Republikës e verifikon **GJKMVe**, sipas detyrës zyrtare (neni 82.2 i **KMVe**). Në rast të pamundësisë që ta ushtrojë funksionin, Presidentin e Republikës e zëvendëson Kryetari i Kuvendit (neni 82.3 i KMVe). Kur Kryetari i Kuvendit e ushtron funksionin e Presidentit të Republikës, ai merr pjesë në punën e Kuvendit pa të drejt vendosjeje (neni 82.4 i **KMVe**).

Detyra e Presidentit të Republikës nuk pajtohet me ushtrimin e funksionit, profesionit tjetër publik ose funksionit në parti politike (neni 83.1 i KMVe). Presidenti gëzon imunitet (neni 83.2 i KMVe). Për heqjen e imunitetit të Presidentit të Republikës vendos **GJKMVe** me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i gjyqtarëve (neni 83.3 i KMVe).

Neni 84 i KMVe numëron kompetencat e Presidentit të Republikës, disa prej të cilave kanë pësuar ndryshime të vogla. Presidenti i Republikës së Maqedonisë cakton mandatarin për formimin e Qeverisë së Republikës të Maqedonisë së Veriut; emëron dhe revokon me dekret ambasadorët dhe përfaqësuesit e Republikës së Maqedonisë së Veriut jashtë vendit; pranon letrat kredenciale dhe revokuese të përfaqësuesve të huaj diplomatikë; propozon dy gjyqtarë të **GJKMVe**; propozon dy

anëtarë të Këshillit Gjyqësor Republikan; emëron tre anëtarë të Këshillit për Siguri të Republikës së Maqedonisë së Veriut; propozon anëtarët e Këshillit për Marrëdhënie Ndëretnike; emëron dhe shkarkon edhe bartës të tjerë të funksioneve shtetërore dhe publike të përcaktuara me **KMVe** dhe me ligj; ndan dekorata dhe mirënjohje në përputhje me ligjin; bën faljen në përputhje me ligjin, dhe kryen detyra të tjera të përcaktuara me KMVe. Me amendamentin XII në KMVe të datës 16 nëntor 2001, është shlyer nënparagrafi 7 i nenit 84, ashtu që presidenti më nuk propozon anëtarët e Këshillit për Marrëdhënie Ndëretnike.

Presidenti i Republikës i raporton Kuvendit për çështjet nga kompetenca e tij së paku një herë brenda vitit (neni 85.1 i **KMVe**). Sikundër shihet, këtu bëhet fjalë për raportim në Kuvend të shefit të shtetit, por nuk qartësohet se çfarë ndodh nëse shefi shtetit i këtij vendi refuzon të bëj një gjë të tillë (sic!). Me sa duket, formulimi është relikt nga e trashëgimia e kaluar e sistemit të kuvendeve që ka ekzistuar në ish-Jugosllavi dhe njësitë e saj federale. Më i duhur do të ishte formulimi sipas së cilit Presidenti i Republikës i drejtohet Kuvendit një herë në vit. Kjo del natyrshëm edhe nga dispozita e paragrafit të dytë të nenit të njëjtë që përcakton se Kuvendi mund të kërkojë nga Presidenti mendim për çështje nga kompetenca e tij (neni 85.2 i **KMVe**).

Presidenti i Republikës është Kryetar i Këshillit për Siguri të Republikës së Maqedonisë (neni 86.1 i **KMVe**). Këshillin për Siguri të Republikës e përbëjnë: Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryetari i Qeverisë, ministrat të cilët udhëheqin me organet e administratës shtetërore në fushat e sigurisë, mbrojtjes dhe të punëve të jashtme dhe tre anëtarë të cilët i emëron Presidenti i Republikës (neni 86.2 i **KMVe**). Këshilli shqyrton çështje lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen e Republikës dhe i jep propozime Kuvendit dhe Qeverisë (neni 86.3 i **KMVe**). Me amendamentin XIII në **KMVe**, datë 16 nëntor 2001, është plotësuar paragrafi dytë i nenit 86 si më sipër, ashtu që tani përcaktohet se, gjatë emërimit të tre anëtarëve, presidenti do të sigurojë që përbërja e Këshillit, si tërësi, në mënyrë përkatëse ta pasqyrojë përbërjen e popullatës në **Republikën e Maqedonisë së Veriut**.

Presidenti i Republikës mban përgjegjësi për shkeljen e Kushtetutës dhe të ligjeve gjatë ushtrimit të të drejtave dhe detyrave të tij (neni 87.1 i **KMVe**). Procedurë për verifikimin e përgjegjësisë së Presidentit të Republikës, ngre Kuvendi me shumicën e dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Për përgjegjësinë e presidentit vendos **GJKMVe** me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i gjyqtarëve (neni 87.2 i **KMVe**). Nëse gardiani kushtetues verifikon përgjegjësinë e Presidentit të Republikës, funksioni i pushon **per constitutionem** (neni 87.3 i **KMVe**).

12. Presidenti i Malit të Zi

Në pjesën e tretë të **KMZi**, kapitulli i dytë përmban nenet 95-99 që normojnë rolin dhe pozitën kushtetuese të shefit të shtetit në Mal të Zi. Përveç që ka shumë pak nene, krahasuar me kushtetutat e vendeve përreth, **KMZi** dallon edhe për faktin se nuk definon qartë fizionominë e këtij organi kushtetues. Kjo, megjithatë, nuk do të thotë se nuk mund të përcaktohet me lehtësi fizionomia e këtij organi kushtetues, gjë që shihet qartë nga kompetencat e tij, me të cilat fillon kapitulli i dytë i pjesës së tretë që rregullon organizimin e pushtetit në këtë vend. Kështu, në një paragraf të vetëm, me 10 pika, Presidentit të Malit të Zi i njihen këto kompetenca kushtetuese: 1. përfaqëson **Malin e Zi** në vend dhe në botën e jashtme; 2. komandon më ushtrinë bazuar në vendimet e Këshillit për Mbrojtje dhe Siguri; 3. me dekret shpall ligjet; 4. shpall zgjedhjet për **Kuvendin e Malit të Zi**; 5. i propozon Kuvendit për sa vijon: mandatarin për formimin e Qeverisë, pas bisedimeve të kryera me përfaqësuesit e forcave politike të përfaqësuara në Kuvend; propozon kryetarin dhe gjyqtarët e **GJKMZi** dhe Avokatin e Popullit; 6. emëron dhe tërheq ambasadorët e **Malit të Zi** në botën e jashtme, sipas propozimit të Qeverisë dhe mendimit të këshillit kompetent të Kuvendit për marrëdhënie ndërkombëtare; 7. lëshon dhe pranon letrat kredenciale dhe të tërheqjes të përfaqësuesve të huaj diplomatik; 8. ndan mirënjohje dhe medalje; 9. jep falje; dhe, së fundi, 10. kryen punë të tjera të përcaktuara me **KMZi** dhe ligj. Me amendamentin V në KMZi, datë 31 korrik 2013, është zëvendësuar

pika e pestë e këtij neni, ashtu që sot presidenti i propozon Kuvendit mandatarin për formimin e Qeverisë, pas bisedave të kryera me përfaqësuesit e partive politike të përfaqësuara në Kuvend, dy gjyqtarë të GJKMZI (pra jo edhe kryetarin e saj) dhe Avokatin e Popullit.

Presidenti zgjidhet në bazë të sistemit të zgjedhjes së përgjithshme dhe votës së barabartë, të drejtpërdrejta dhe të fshehta (neni 96.1 i **KMZi**). Për president mund të zgjidhet shtetasi malazez që ka pasur së paku 10 vite vendbanimin në **Mal të Zi** në 15 vitet e fundit (neni 96.2 i KMZi). Zgjedhjet për President të Republikës i shpall kryetari Kuvendit (neni 96.3 i **KMZi**). Mandati i shefit të shtetit në **Mal të Zi** zgjat pesë vite (neni 97.1 i **KMZi**) me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë (neni 97.2 i **KMZi**). Detyra nis ditën e dhënies së betimit para deputetëve të Kuvendit (neni 97.3 i **KMZi**). Nëse mandati përfundon në kohë lufte ose gjendjeje të jashtëzakonshme, atëherë ai vazhdohet edhe për 90 ditë të tjera pas pushimit të rrethanave që kanë shkaktuar këtë vazhdim (neni 97.4 i KMZi). Presidenti nuk mund të ushtroj asnjë funksion tjetër publik (neni 97.5 i **KMZi**). Kjo nënkupton se shefi shtetit malazez mund të jetë shef partie dhe bartës i funksioneve të tjera partiake, sepse **KMZi** ndalon vetëm ushtrimin e çfarëdo posti tjetër publik.

Ngushtësisht e lidhur me mandatin është edhe çështja e **ndërprerjes** së tij. Mandati përfundon me kalimin e kohës për të cilën është zgjedhur, me dorëheqje, nëse në mënyrë të përhershme pengohet për të ushtruar detyrën e presidentit dhe me shkarkim (neni 98.1 i **KMZi**). Presidenti përgjigjet për shkelje të **KMZi** (neni 98.2 i **KMZi**). Procedurën për vërtetimin nëse presidenti Malit të Zi ka shkelur **KMZi** mund ta filloj Kuvendi, me propozimin e së paku 25 deputetëve (neni 98.3 i **KMZi**). Vendimin për shkelje ose jo të **KMZi** e merr **GJKMZi**, e cila pa vonesë e shpall dhe ua dërgon Kuvendit dhe presidentit të Malit të Zi (neni 98.4 i **KMZi**). Në rast të ndërprerjes së mandatit, si dhe në rastet e pengesave të përhershme për ushtrimin e detyrës, deri në zgjedhjen e presidentit të ri atë funksionin e ushtron Kryetari Kuvendit (neni 99 i **KMZi**).

13. Presidenti i Serbisë

Në pjesën e pestë të **KSerb**, që nromon marrëdhëniet e pushtetit, kapitulli i dytë i kushtohet shefit të shtetit serb (nenet 111-121). Me titullin ”Pozita e presidentit të Republikës”, neni 111 i KSerb qartë tregon se ky organ shtetëror shpreh unitetin shtetëror të Republikës së Serbisë. Kjo fizionomi e përcaktuar kësisoj, hapur mbështetet në konceptin shmitian mbi shefin e shtetit, si simbol i unitetit shtetëror, pra jo i atij popullor, e aq më pak qytetar, siç e bëjnë kushtetutat e vendeve të tjera fqinje me Kosovën. Këtu nuk ka rëndësi fakti se kompetencat ekzekutive të shefit të shtetit serb nuk janë të plota, përkatësisht janë të natyrës gjysmë-presidenciale. Vetë fakti që fokusi i kushtetutëbërësit serb koncentrohet në unitetin shtetëror e bën të qartë qasjen shmitiane mbi shefin e shtetit si simbol i unitetit shtetëror, ku aspektet tjera popullore dhe qytetare absorbohen në këtë simbolikë mbi unitetin shtetëror. Se kjo është kështu tutje reflektohet edhe në kompetencat e theksuara etatike të presidentit të Serbisë. Sipas paragrafit të parë të nenit 112 të **KSerb**, Presidenti i Republikës ka këto kompetenca: 1. Përfaqëson Republikën e Serbisë në vend dhe në botën e jashtme; 2. me dekret shpall ligje, në pajtim me KSerb; 3. i propozon Kuvendit të Serbisë kandidatin për kryetar të Qeverisë, pasi të dëgjoj mendimin e përfaqësuesve të listave fituese zgjedhore; 4. I propozon Kuvendit bartësit e funksioneve, në pajtim me **KSerb** dhe ligjin; 5. Cakton dhe shkarkon me dekret ambasadorët e **Republikës së Serbisë** në bazë të propozimit të Qeverisë; 6. pranon letrat kredenciale dhe të tërheqjes të përfaqësuesve të huaj diplomatik; 7. Jep falje dhe medalje; 8. Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me **KSerb**. Në paragrafin e dytë të këtij neni përcaktohet se Presidenti i Republikës, në pajtim me ligjin, komandon ushtrinë, gradon dhe shkarkon oficerët e ushtrisë së Serbisë. Pra, ky paragraf e bën ligjin si pikë referimi, si parametër për kompetencat e presidentit në komandim, gradim dhe shkarkim të oficerëve të ushtrisë së Serbisë. Gjithashtu, siç shihet, me rastin e caktimit të mandatarit, presidenti vetëm ka për detyrë t’i dëgjoj forcat politike, pra jo edhe të varet nga ai mendim.

Presidenti ka detyrim kushtetues të shpall ligjet 15 ditë nga miratimi tyre, përkatësisht më së voni brenda 8 ditëve nëse ligji është miratuar me procedurë të përshpejtuar, duke nxjerr dekret mbi shpalljen e ligjit, ose të kthej të njëjtin në Kuvend për rivendosje, me një arsyetim me shkrim (neni 113.1 i **KSerb**). Nëse Kuvendi vendos për votim të ligjit të njëjtë që është kthyer nga Presidenti i Republikës, atëherë për miratim të tij kërkohet vota e shumicës absolute në Kuvend (neni 113.2 i **KSerb**). Nëse në rivotim ligji fiton votat e shumicës absolute të deputetëve të Kuvendit, presidenti ka detyrim kushtetues të shpall ligjin e tillë (neni 113.3 i **KSerb**).

Presidenti zgjidhet në zgjedhje të drejtpërdrejta, me votim të fshehtë, në pajtim me ligjin (neni 114.1 i **KSerb**). Siç mund të shihet, kjo dispozitë është mjaft e ngjashme me zgjidhjet kushtetuese malazeze për të njëjtën çështje, siç është edhe dispozita në vijim, sipas të cilës zgjedhjet për President të Serbisë i shpall Kryetari i Kuvendit, 90 ditë para mbarimit të mandatit të presidentit aktual, ashtu që zgjedhjet përfundojnë 60 ditët në vijim në pasjim me ligjin (neni 114.2 i **KSerb**). Me rastin e hyrjes në detyrë, presidenti i Serbisë, para Kuvendit jep betim duke lexuar tekstin si vijon: "Betohem se tërë fuqinë do t'ia kushtoj ruajtjes së sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Republikës së Serbisë, përfshirë Kosovën dhe Metohinë, si pjesë e saj, si dhe realizimit të lirive dhe të drejtave njerëzore dhe të minoriteteve, respektimit të Kushtetutës dhe ligjit, ruajtjes së paqes dhe mirëqenies së krejt qytetarëve të Republikës së Serbisë dhe që me ndërgjegje e përgjegjësi do t'i plotësojë krejt detyrat e mia"! (neni 114.3 i **KSerb**). Sikundër shihet nga kjo dispozitë, shefi shtetit serb duhet të betohet në Kosovë, në ruajtjen e saj brenda sovranitetit imagjinar dhe fiktiv serb, betim ky shumë sakral dhe ngjason në zotimet mesjetare për ruajtjen e një objekti metafizik për gjeneratat që vijnë. Në dispozitën e fundit të këtij neni, njëjtë si në zgjidhjen kushtetuese malazeze, përcaktohet se Presidenti Republikës nuk mund të ushtroj asnjë funksion tjetër publik apo veprimtari profesionale. Kjo nënkupton se shefi Shtetit serb mund të jetë funksionar i partisë politike dhe lider i saj.

Mandati i presidentit të Serbisë zgjat pesë vite dhe fillon të rrjedh nga dita e dhënies së betimit para Kuvendit të Serbisë (neni 116.1 i **KSerb**). Nëse mandati skadon gjatë kohës së luftës dhe gjendjes së jashtëzakonshme, ai vazhdohet deri me kalimin e tre muajve nga dita e përfundimit të gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme (neni 116.2 i **KSerb**). Askush nuk mund të jetë president më shumë se dy herë (neni 116.3 i **KSerb**). Mandati i presidentit përfundon me kalimin e kohës për të cilën është zgjedhur, me dorëheqje ose me shkarkim (neni 116.4 i KSerb). Dorëheqja i paraqitet kryetarit të Kuvendit (neni 116.5 i **KSerb**). Është e çuditshme se KSerb, pas kësaj dispozite mbi dorëheqjen, me titull të veçantë "Dorëheqja" **në një nen të veçantë sërish flet për institutin e dorëheqjes së shefit të shtetit. Aty, në nenin 117, KSerb** thotë se kur presidenti jep dorëheqje, informon publikun dhe kryetarin e Kuvendit (neni 117.1 i **KSerb**). Ditën e paraqitjes së dorëheqjes pushon mandati shefit të shtetit në Serbi (neni 117.2 i **KSerb**). Edhe për shkarkimin, kushtetutëbër**ësi serb ka vetëm një nen, nenin 118. Presidenti shkarkohet për shkak të shkeljes së KSerb**, me vendim të Kuvendit, që merret me votat e së paku dy të tretave të krejt deputetëve (neni 118.1 i **KSerb**). Procedura për shkarkim mund të fillohet nga Kuvendi, sipas propozimit të së paku një të tretës së deputetëve (neni 118.2 i KSerb). **GJKSerb** është e detyruar që vendos, më së voni 45 ditë nga dita e nisjes së procedurës, lidhur me ekzistimin ose jo të shkeljes së **KSerb** nga ana e presidentit (neni 118.3 i **KSerb**).

Presidenti gëzon **imunitet** sikur deputeti i Kuvendit (neni 119.1 i **KSerb**). Mbi imunitetin vendos Kuvendi (neni 119.2 i **KSerb**). Kjo dispozitë mbi imunitetin pasohet nga dispozita mbi zëvendësimin në detyrë të presidentit të Republikës. Kur presidenti është i penguar në ushtrimin e detyrës apo kur mandati i ndërpritet para kohës për të cilën është zgjedhur, atë e zëvendëson kryetari Kuvendit (neni 120.1 i **KSerb**). Kryetari Kuvendit mund ta zëvendësoj presidentin e Republikës më së shumti për tre muaj (neni 120.2 i **KSerb**). Zgjedhjet për president të Republikës, kryetari Kuvendit është i detyruar t'i shpallë ashtu që ato të mbahen më së voni tre muaj nga pushimi i pengesave të Presidentit të Republikës për ushtrim të funksionit, përkatësisht nga përfundimi mandatit për të cilin është zgjedhur

(neni 120.3 i **KSerb**). Neni i fundit i këtij kapitulli thotë se për institucionin e Presidentit të Republikës miratohen një ligj i veçantë (neni 121 i **KSerb**).

14. Ekzekutivi

Qeveria është organ i pushtetit ekzekutiv i përcaktuar me kushtetutë. Si njëri prej organeve më të larta të pushtetit, me të merret e drejta kushtetuese, e cila e studion dhe hulumton, kurse për nga natyra ai është edhe organ politik. Qeveria **krijon dhe zbaton politikën në shtet**, së bashku me organet tjera të pushtetit, shefin e shtetit dhe parlamentin. Për dallim nga shefi i shtetit, qeveria nuk njihet në të gjitha sistemet e pushtetit: nuk ekziston në sistemin presidencial, ku krejt pushteti ekzekutiv gjendet në duart e Presidentit të Republikës.

Në **pushtetin ekzekutiv bicefal** (në dy koka), qeveria dhe shefi i shtetit bashkëpunojnë: në sistemin parlamentar, pushteti ekzekutiv i takon qeverisë kurse në sistemin e përzier pushteti më i madh politik mund të jetë në duart e Presidentit të Republikës. Duhet thënë se në ekzekutivin bicefal, pushteti ekzekutiv mund të jetë politikisht monolit (i unifikuar) ose kohabitues (shefi shtetit është nga partia opozitare kurse shefi ekzekutivit nga partia në pushtet). Aty ku qeveria është politikisht e fortë dhe autonome në marrjen e vendimeve, shefi shtetit ngelet pa pushtet real. Në sistemet e kuvendeve, qeveria ka qenë praktikisht një trup i posaçëm i kuvendit, organ ekzekutiv i tij që ka zbatuar urdhrat dhe ka raportuar para tij.

Qeveria përbëhet nga funksionarët më të lartë shtetërorë, ministrave. Ata gjenden, sipas rregullit, në krye të resorëve administrativë. Puna e tyre është punë e koordinuar, ata paraqiten së bashku dhe me pajtim maksimal përcaktojnë dhe zbatojnë politikën e shtetit. Funksioni ministror është i **natyrës juridiko-publike**, pra rregullohet me normat e të drejtës publike, kryesisht me normat e të drejtës kushtetuese dhe të drejtës administrative.

14.1. Origjina dhe llojet e qeverisë

Qeveria ashtu siç e njohim sot, si një fenomen juridik-kushtetues shkencërisht i shtjelluar dhe përpunuar, nuk ka lindur përnjëherë dhe as nuk është krijuar së pari modeli teorik i saj. Ka fituar pamjen që ka qenë fryt i përvojës dhe marrëdhënieve mes shefit të shtetit dhe parlamentit, përkatësisht pararendësve të tyre, **sovranëve** (monarkëve), **kuvendeve të fisnikëve** dhe **këshillave mbretëror**.

Njëjtë sikur institucionet tjera të sistemit parlamentar, qeveria është farkëtuar e formësuar brenda zhvillimit politik të Anglisë mesjetare. Monarku, i shtypur dhe nën trysninë e kuvendeve të fisnikëve, ka mbledhur rreth vetes bashkëpunëtorë me qëllim të kundërvënies politike ndaj aristokracisë së madhe feudale, e cila, me kalimin e kohës, nis e organizohet në parlament. Në oborrin e tyre, monarkët formojnë një trup, këshillin sekret, i përbërë nga bashkëpunëtorë e këshilltarë, me qëllim të luftës politike kundër parlamentit. Me kalimin e kohës, këta këshilltarë e bashkëpunëtorë marrin thirrjen e ministrave, nga fjala latine **minister** që do të thotë **shërbëtor**. Një kohë të gjatë, ky funksion ka pasur karakter juridiko-privat: janë vënë nga monarku, ai i ka zëvendësuar me të tjerët, i ka dënuar e disiplinuar, thjeshtë janë varur nga vullneti ekskluziv i kurorës.

Me qëllim të zvogëlimit të konflikteve me parlamentin gjithnjë e më të fuqishëm, monarku fillon të caktojë ministrat e tij nga radhët e parlamentit, përkatësisht të atyre që gëzojnë mbështetjen joformale të parlamentit. Në këtë mënyrë, funksioni ministror merr çdo herë e më shumë karakter juridiko-publik: ministrat nuk varen më vetëm nga vullneti monarkut por edhe nga vullneti i shumicës politike në parlament. Kjo praktikisht i ka afruar ata me parlamentin dhe i ka larguar nga kurora, aq shumë deri në një moment kur ministrat më nuk mund të zëvendësoheshin pa vullnetin e përfaqësuesve në parlament. Koha e lindjes së qeverisë parlamentare, e qeverisë që politikisht i përgjigjet

parlamentit, njihet si epoka e **Revolucionit të Madhërishëm** (1688 e tutje).[148] Me këtë **revolucion pa fije gjaku**, siç u cilësua nga bashkëkohësit, u krijuan parakushtet që qeveria të zhvendoset nga monarku që ishte politikisht dhe juridikisht i papërgjegjshëm në parlament. Autonom nga monarkët britanikë të kohës (nga dinastia **Hanoverit**), tani e tutje i përgjigjen shumicës parlamentare, duke krijuar kësisoj një institucion të ri politik – qeverinë parlamentare, të përgjegjshme para parlamentit dhe të zëvendësueshme nga ai.[149] Me kushtetuat e para të shkruara, një shekull më vonë, u rregullua pozita e qeverisë në mënyrë të njëjtë siç rregullohet me kushtetutat e sotme, u mor vesh me përmbajtje të tjera më të ndryshme sesa qeveritë e dikurshme.

Më qëllim të kuptimit sa më të mirë të vetë institucionit të qeverisë, e dobishme është të dallohen **llojet qeverisë**, të cilat klasifikohen sipas kritereve të ndryshme. Qeveria është organ politik që përbëhet nga paria politike, por ekzistojnë edhe qeveri që nga përbërja e tyre janë apolitike, jopartiake. Përveç të rregullta, qeveritë mund të jenë edhe kalimtare, kur ato formohen në një kohë për tejkalim të situatës dhe si një zgjidhje e përkohshme.

Në **sisteme të ndryshme të pushtetit**, për nga **pozita e qeverisë** ekzistojnë zgjidhje të ndryshme: një sistem parlamentar karakterizohet nga qeveria parlamentare, e cila i përgjigjet organi përfaqësues por edhe ka një rol dominant politik; në sistemin e përzier, dominimin e qeverisë parlamentare e rrezikon pozita e Presidentit të Republikës; në sistemin e kuvendeve, ndërkaq, qeveria ka një pozitë të varur politike dhe shërben si një trup ekzekutiv i kuvendit; dhe, së fundi, në sistemin presidencial, qeveria as që ekziston.

Sipas kriterit që bazohet në **pozitën e ministrave të qeverisë**, ekzistojnë dy lloje të qeverive. Në qeverinë parlamentare, secili prej ministrave ndërton pozitën e vetë juridiko-kushtetuese me parlamentin, i cili i zgjedh dhe para të cilit janë përgjegjës. Në qeverinë kancelarike (Gjermania), theksi vihet të kryetari i qeverisë, **kancelari**, i cili si i vetëm ka dal nga shumica parlamentare. Qeveria këtu është si një ekip i kancelarit. Ai propozon zgjedhjen dhe zëvendësimin e anëtarëve të qeverisë, ku vendimin formal e merr shefi i shtetit, por ka rëndësi që ministrat nuk kanë një marrëdhënie juridiko-kushtetuese të drejtpërdrejtë me parlamentin.

Sa i përket **përbërjes politike**, qeveritë ndahen në njëpartiake, koalicioni, të pakicës dhe të koncentruara. Siç tregon vetë fjala, **qeverinë njëpartiake** e formon një parti politike, gjë që ndodh, si rregull, në vendet me **sistem zgjedhor të shumicës relative** (Britania e Madhe), kurse në vendet me **sistem zgjedhor proporcional** kjo është shumë më e rrallë. Qeveria njëpartiake është shumë stabile, pas saj qëndron shumica homogjene parlamentare e një partie politike, e cila ia mundëson qëndrimin në pushtet përgjatë mandatit të plotë. **Qeveria e koalicionit** përbëhet prej dy ose më shumë partive politike, të cilat lidhin marrëveshje koalicioni. Ky lloj i qeverisë është rregull në sistemin zgjedhor proporcional, por edhe në sistemin e shumicës absolute. Kjo është qeveri e kompromisit politik të partive dhe programeve të tyre, jo stabile krahasuar me qeverinë njëpartiake dhe zgjat aq sa edhe koalicioni partiak në parlament. Në **qeverinë e pakicës** hyjnë një ose disa parti politike prapa të cilave nuk qëndron shumica parlamentare. Këtë lloj qeverie, për arsye të ndryshme politike, e mbështet partia që nuk ka ministra, por i siguron qeverisë shumicën parlamentare dhe, për pasojë, edhe vetë jetën në pushtet. **Qeveria e koncentruar** (e unitetit kombëtar, shpëtimit kombëtar), sipas përbërjes së saj është qeveria më e gjerë. Në të futen përfaqësuesit e partive parlamentare (mund të hyjnë edhe personalitete jopolitike) dhe formohet në kohët e krizave parlamentare, luftërave, gjendjeve të jashtëzakonshme apo në kohët kalimtare deri në nxjerrjen e kushtetutës së re. Gjatë

148 Cf. më shumë në Henry Gerald Richardson, Georg Osborne Sayles, *The English Parliament in the Middle Ages* (Hambeldon: London, 1981); Gerald Harriss, "Political Society and the Growth of Government in Late Medieval England". *Past & Present* No. 138 (February 1993), fq. 28-57.

149 Cf. më shumë në Gary W. Cox, "Was the Glorious Revolution a Constitutional Watershed?". *The Journal of Economic History* Vol. 72 No. 3 (September 2012), fq. 567-600.

tërë kohës sa qëndron në pushtet, ajo shpreh konsensusin politik dhe unitetin demokratik të forcave politike.

Sipas kriterit të **lejueshmërisë së anëtarësimit paralel në qeveri dhe parlament**, qeveritë ndahen në qeveri deputetësh, jodeputetësh dhe të përziera. Nëse ministri mund të jetë vetëm nga radhët e deputetëve, atëherë flasim për qeveri deputetësh (Britania e Madhe). Në këto raste ekziston një lidhje e ngushtë, përbashkësi, simbiozë politike mes qeverisë dhe parlamentit në krijimin, udhëheqjen dhe zbatimin e politikës shtetërore. Qeveri jodeputetësh ekziston në ato sisteme ku funksioni ministrit është i papajtueshëm me postin e deputetit (Franca). Këtu theksi vihet te ndarja e qeverisë nga parlamentit, në mënyrë që të jetë më stabile dhe më e pavarur. Qeveri të përziera janë ato për të cilat nuk ekzistojnë norma imperative (të detyrueshme) mbi pajtueshmërinë ose jo mes funksioneve të ministrit dhe deputetit. Në këto raste ministri mund të jetë në të njëjtën kohë edhe deputet, por nuk është e domosdoshme (rasti Serbisë sipas Kushtetutës së vitit 1990).

Të gjitha llojet si më sipër të qeverive janë qeveri partiake dhe politike. Qeveria nuk duhet të ketë medoemos përbërje politike, në to mund të futen edhe personalitet jopartiake për shkak se janë ekspertë të njohur të fushës së caktuar (ekonomia, drejtësia, financar, bujqësia etj) dhe mund të kontribuojnë në suksesin e qeverisë. Kur ministrat jopartiakë dominojnë qeverinë, atëherë flasim për qeveri ekspertësh, teknokratësh, burokratësh ose profesionistësh. Këto janë qeveri kalimtare, zakonisht në kohë më të shkurtra, për shkak se janë kundër natyrës së qeverisë si organ i pushtetit politik që buron nga vullneti politik i qytetarëve dhe parlamentit. Ata punojnë me qëllim që në një kohë të shkurtër të tejkalojnë gjendjen e keqe ose krizën në fusha të caktuar shoqërore.

Qeveri të caktuara kanë ekzistuar në periudha të caktuara kohore ose shtete të veçanta. **Qeveria e kabinetit** është zbulim britanik. Në të nuk futen krejt anëtarët e qeverisë por vetëm ata më të rëndësishmit (**seniors**: 21-23 anëtarë). Krejt qeveria nuk takohet në përbërje të plotë por vetëm si kabinet, ose, edhe në përbërje më të ngushtë, si kabinet i brendshëm që përbëhet nga kryeministri dhe disa prej ministrave. Posedon me manualin e vet, që përmban rregullat dhe procedurat për punën e qeverisë.[150]

Qeveritë mund të shprehin dhe përfaqësojnë **ideologji të ndryshme** nga ato që karakterizojnë shtetin e së drejtës, sundimin e kushtetutës dhe sovranitetin popullor (nacional). **Qeveria aristokratike** është një qeveri tradicionale, kryesisht e tejkaluar në aspektin historik, dhe të cilën e përbëjnë anëtarët për nga prejardhja e tyre (anëtarët e dinastisë sunduese, siç është rasti, ta zëmë, me Arabinë Saudite). Te ky lloj i qeverisë fuqia ekzekutive gjendet ekskluzivisht në duart e një grupi të vogël të njerëzve të privilegjuar për nga prejardhja e tyre e gjakut.[151] Kategori historike të qeverisë janë edhe **qeveritë despotike** dhe **diktatoriale**, të modelit të ri ose të vjetër, cilat udhëhiqen nga vullneti i despotit ose diktatorit.[152] **Qeveria anarkike** është ajo qeveri që ideologjikisht nuk pranon rendin ekzistues juridik dhe synon që ta përmbysë në mënyrë revolucionare (i tillë ka qenë, ta zëmë, rasti i qeverisë anarkiko-sindikaliste në **Spanjën** e viteve 1936-1939).[153] **Qeveria plutokratike** përbëhet

[150] Cf. më shumë në Cristina Barbieri and Michelangelo Vercesi, "The Cabinet: A Viable Definition and its Composition in View of a Comparative Analysis". *Government and Oposition* Vol. 48 No. 4 (October 2013), fq. 526-547.

[151] Kur aristokratët ndajnë pushtetin me të tjerët dhe ndjekin politika liberale, që bazohen në sundimin e ligjit, kushtetutës dhe sovranitetit popullor, atëherë bëhet fjalë për lloj tjetër të qeverisë, siç është rasti me Britaninë e Madhe. Cf. më shumë për zhvillimin historik të qeverisjes kabinetike britanike, me rolin e veçantë të aristokracisë në zhvillimin e sundimit të ligjit dhe konstitucionalizmit britanik në Peter Mandler, *Aristocratic Government in the Age of Reform Whigs and Liberals 1830-1852* (Clarendon Press: Oxford, 1990).

[152] Cf. më shumë në Manfred F.R. Kets de Vries, "The spirit of despotism: Understanding the tyrant within" *Human Relations* Vol. 59 No. 2 (February 2006), fq. 195-220; Mario Turchetti, "Despotism' and 'Tyranny'. Unmasking a Tenacious Confusion". *European Journal of Political Theory*, Vol. 7 No. 2 (2008), fq. 159–182; John Keane *The New Despotism* (Harvard University Press: Cambridge, Massachusetts, 2020).

[153] Cf. më shumë në Danny Evans, *Revolution and the State: Anarchism in the Spanish Civil war, 1936–1939* (Rout-

nga të pasurit, me ideologjinë e saj mbron interesat e tyre. [154] Lloj i veçantë i këtij grupimi është edhe **qeveria kleptokratike** (e korruptuar), e cila me veprimtarinë e vet interesat private dhe të ngushta i mbron dhe kultivon kundrejt interesave të përgjithshme dhe shtetërore.[155] E ngjashme me këtë në kuptimin e fenomenologjisë politike është **qeveria marionetë** ose **qeveria kukull**, e cila zbaton politikën shtetërore për interes dhe llogari të huaj politike, ushtarake ose financiare, jo për interes dhe në dobi të vendit. Si shembuj të këtij lloji qeverie merren qeveritë në disa vende ish-koloniale.[156] Një lloj i posaçëm i qeverisë së përkohshme përfaqëson **qeveria në ekzil**, e cila për shkak të luftës ka lëshuar territorin shtetëror por vazhdon të ngelet legjitime jashtë vendit dhe pranohet nga shumica e vendeve demokratike të botës ose nga disa prej tyre. Rast tipik i kësaj kanë qenë qeveritë e vendeve të Evropës që u okupuan nga regjimi nazi-fashist gjatë viteve 1939-1941. Si rasti më interesant i tyre është ai vendeve baltike, që vendet perëndimore i njohën edhe pas ripushtimit të tyre sovjetik më 1945, bazuar në pavlefshmërinë e paktit famëkeq **Ribentrop-Molotov** të lidhur në **Moskë** me 23 gusht 1939.[157]

14.2. Zgjedhja dhe mandati

Mund të thuhet se qeverinë e zgjedhin qytetarët në mënyrë të tërthortë, përmes parlamentit. Qeverinë e formon dhe e mban në pushtet shumica parlamentare. Nëse do të jetë e mundur zgjedhja e qeverisë, kjo varet nga konfiguracioni forcave politike në parlament. Nëse nuk ekziston një forcë politike që komandon mbi gjysmën e përfaqësuesve, atëherë duhet të ketë vullnet e gatishmëri e më shumë forcave politike për të formuar koalicion paszgjedhor në një kohë të përcaktuar me kushtetutë. Në të kundërtën, moszgjedhja e qeverisë, dështimi për formimin e saj, nënkupton zgjedhje të reja parlamentare. Zgjedhja qeverisë mund të jetë e vështirë në veçanti aty ku kërkohet pëlqimi i dy dhomave të parlamentit (**Italia, Japonia**), për shkak se përbërja e tyre politike dhe partiake mund të jetë e ndryshme. Në zgjedhjen e qeverisë marrin pjesë dy subjekte, kurse në sistemin e përzier, presidenti emëron kryeministrin dhe ministrat, të cilët duhet të kenë mbështetjen e shumicës në dhomën e ulët të parlamentit (**Franca**).

Qeveria zgjidhet pas përfundimit të zgjedhjeve parlamentare dhe konstitutimit të parlamentit. Qeveria zgjidhet edhe pas largimit të qeverisë paraprake, për shkak se ndaj saj është votuar mos-

ledge: London and New York, 2018).

154 Cf. më gjerësisht për kuptimin e qeverisë ploutokratike dhe shembujt praktik të formimit të saj në kohët e sotme në Lo Littler, "Meritocracy as Plutocracy: The Marketising of 'Equality' Under Neoliberalism". *New Formations* Nos. 80 and 81 (Winter, 2013), fq. 52-72; Joanne Barkan, "Plutocrats at Work: Hoë Big Philanthropy Undermines Democracy". *Social Research* Vol. 80 No. 2 (Summer 2013), fq. 635-652.

155 Cf. mëm shumë në Alexander Cooley, John Heathershaë, and J. C. Sharman. "The Rise of Kleptocracy: Laundering Cash, Whitewashing Reputations". *Journal of Democracy*, Vol. 29 No. 1 (Janury 2018), fq. 39-53.

156 Për periduhën mes dy luftërave botërore, cf. më shumë në Franz Michael, "The Significance of Puppet Governments". *Pacific Affairs* Vol. 12 No. 4 (December, 1939), fq. 400-412; për rastet tjera gjatë Luftës së Dytë Botërore, cf. më shumë në Raphael Lemkin, *Axixs Rule in Occupied Europe. Laws of Occupation, Analysis of Government Proposals for Redress* (The Lawbook Exchange Ltd.: Clark, New Jersey, 2005); për qeveritë kukull gjatë dhe pas kohës së dekolonizimit në vitet '60 dhe '70 të shekullit të kaluar, cf. më shumë në Alberto Alesina & David Dollar, "Who Gives Foreign Aid to Whom and Why?" *Journal of Economic Growth* Volume **5**, No. 1 (March 2000), fq. 33–63; Christopher Clague, Suzzanne Gleason, Stephen Knack, "Determinants of Lasting Democracy in Poor Countries: Culture, Development, and Institutions". *The ANNALS of the American Academy of Political and Social Science* Vol. 573 No. 1 (2001), fq. 16–41 (ndikimi i qeverive koloniale në ndërtimin e politikave qeveritare në ish-kolonitë e tyre të varura nga mteropola).

157 Cf. më shumë për këtë në Daniel Bell and Leon Dennen, "The System of Governments in Exile". *The ANNALS of the American Academy of Political and Social Science* Vol. 232, A Challenge to Peacemakers (March 1944), fq. 134-147; William J.H. Hough, III, "The Annexation of the Baltic States and Its Effect on the Development of Law Prohibiting Forcible Seizure of Territory", *NYLS Journal of International and Comparative Law* Vol. 6 No. 2 (1985), fq. 303-533; Stefan Talmon, "Who is a legitimate government in exile? Towards normative criteria for governmental legitimacy in international Law". Në Guy Goodwin-Gill and Stefan Talmon (eds.), *The Reality of International Law. Essays in Honour of Ian Brownlie* (Oxford University Press: Oxford, 1999), fq. 499-537.

besimi ose ka dhënë dorëheqje. Ka raste kur vetë akti i votimit të mosbesimit nënkupton zgjedhje të qeverisë së re, siç është rasti me të a.q. **votimin konstruktiv i mosbesimit**, ku nuk mund të votohet për mosbesim të qeverisë pa u siguruar shumica për zgjedhjen e qeverisë së re, në të njëjtën kohë me votimin e mosbesimit ndaj qeverisë së vjetër (**Gjermania**, **Italia**, **Spanja**). Nëse për zgjedhjen e qeverisë është i përcaktuar një **afat**, atëherë lëshimi tij nënkupton shpërndarje të parlamentit **per constitutionem** dhe shpallje e zgjedhjeve të reja, p**ër shkak** se parlamenti i copëzuar politikisht nuk ka qenë në gjendje të zgjedh qeverinë brenda afatit të përcaktuar kushtetues. Nga konstituimi i parlamentit të ri, sërish nisin të rrjedhin afatet kushtetuese për formimin e qeverisë së re. Nëse nuk ekziston një afat për zgjedhje të qeverisë (**Belgjika**, **Bosnjë-Hercegovina**), atëherë qeveria e vjetër rrinë në detyrë deri të zgjidhet qeveria e re.

Procedurën për formim të qeverisë më së shpeshti e fillon shefi shtetit. Atje ku pas zgjedhjeve ekziston një shumicë politike e qartë dhe e dallueshme, shefi i shtetit ia ndan mandatin liderit të partisë që ka më së shumti vende në parlament, pa konsultim paraprak me partitë në parlament (Britania e Madhe). Pas paraqitjes së programit të qeverisë së mandatarit në parlament (në Britaninë e Madhe e lexon kurora), qeveria fillon mandatin e saj, edhe para votimit mbi zgjedhjen e qeverisë (Britania e Madhe, India, Kanada, Zelanda e Re). Edhe në vendet tjera ekziston mundësia që shefi shtetit të ndaj mandatin për formim të qeverisë pa konsultime të posaçme, nëse është e qartë shumica parlamentare, por mund edhe mos të votohet për qeverinë para fillimit të mandatit (**Franca**).

Është e zakonshme që shefi i shtetit, pa konsultimin me liderët e forcave politike, të emëroj mandatarin, i cili, vet (**qeveria kancelarike**) ose me kandidatët për ministra (**qeveria parlamentare**) duhet të fitoj mbështetjen e parlamentit (**Austria**, **Gjermania, Italia**, **Spanja**). Ekzistojnë variacione kur mandatarin e propozon dhoma e ulët e parlamentit, kurse shefin e shtetit e emëron shefi i shtetit (**Irlanda**), kur mandatarin e propozon kryetari kuvendit, kurse për qeverinë voton parlamenti (**Suedia**), kur për mandatarin votohet në shumë rrethe me sistem të eliminimit, ashtu që në fund kryeministrin (ministrin e ngelur në votim) e emëron formalisht shefi shtetit (**Japonia**). Në mënyrë jo të zakonshme, ekzistojnë raste kur për kryeministrin votohet drejtpërdrejt në vota popullore (**Izraeli**: 1996-2003, tani ka ndryshuar).

Kandidati për kryeministër nuk është i kufizuar me numrin e mandateve. Ai do të jetë kryetar qeverie aq herë sa të merr besimin e shumicës parlamentare. Mandatari më së shpeshti është person politik, që do të thotë se duhet të gëzojë mbështetjen e partisë së vet ose forcës politike nga vjen, për shkak se qeveria është organ politik. Shumë rrallë mandatari është ekspert jopartiak ose teknokrat. Mandatari paraqet në parlament **programin e qeverisë** së ardhshme dhe përbërjen e qeverisë. Zakonisht në program, përmes formulimeve të përgjithësuara, përmbahen drejtimet e përgjithshme të veprimit të qeverisë dhe orientimi dhe qëllimet e saj politike, si dhe çështjet e mëdha politike aktuale. Përbërja e qeverisë është rezultat i marrëveshjes politike, brenda partisë politike ose koalicionit.

Mandati i qeverisë fillon me betimin që qeveria e jep në parlament. Zgjatja e mandatit zakonisht nuk përcaktohet në vite, ani pse ekzistojnë zgjidhje të tilla kushtetuese, për shkak se qëndrimi në pushtet varet nga rrethanat e ardhshme politike të pasigurta – besimi i shumicës në parlament. Qeveria njëpartiake stabile, praktikisht vetë vendos nëse do të ndërpres mandatin e saj, në ndërkohë që qeveritë e koalicionit janë, në parim, më pak afatgjate. Në histori ka raste kur shtetet përgjatë një epoke nuk kanë pasur qeveri që ka qëndruar gjatë tërë mandatit parlamentar, si dhe qeveri që kanë zgjatur më pak se një vit: kështu, ta zëmë, 108 qeveri gjatë kohës së Republikës së Tretë Franceze 1875-1940, qeveri italiane me nga gjashtë deri në shtatë muaj deri me ardhjen në pushtet të qeverisë së Silvio Berluskonit (Silvio Berlusconi: 2001-2005), më së gjati në Republikën italiane. Nëse qeveria do të realizojë mandat të plotë ose të shkurtër, kjo varet nga rrethanat konkrete

politike, të cilat përbëhen nga faktorët siç janë: numri partive politike që marrin pjesë në qeveri, përbërja partiake e parlamentit, numri deputetëve të koalicionin në pushtet, uniteti ideologjik i qeverisë, gjendja sociale dhe ekonomike në shtet dhe shumë faktorë të tjerë.
Qeveria do të ketë mandat më të shkurtër në raport me mandatin e parlamentit nëse kryeministri ose krejt qeveria japin dorëheqje. **Dorëheqja** është akt i vullnetit politik të qeverisë ose shefit të saj dhe mund të jepet për shkaqe të ndryshme. Kështu, ta zëmë, qeveria ose shefi i saj, në bazë të hulumtimit të opinionit publik, mund të vlerësojnë se është koha më e mirë për zgjedhje të jashtëzakonshme dhe mandat të ri; dorëheqja mund të vjen edhe si pasojë e ndonjë afere që trondit qeverinë dhe prish marrëdhënien në koalicion mes partnerëve. Me dorëheqje, qeveria mund të anashkaloj votimin e mosbesimit ndaj saj. Ekzekutivi është pushtet aktiv, i cili duhet të ketë kontinuitet, ashtu që qeveria në dorëheqje apo qeveria në detyrë të mund të kryej punët e përditshme si dhe ato punë që nuk mund të shtyhen. Qeverisë së tillë teknike i **ngushtohen kompetencat**: nuk mund të propozoj shpërndarjen e parlamentit, nuk mund të marrë detyrime ndërkombëtare, emëroj (caktoj) zyrtarë të lartë shtetërorë etj.

Njëjtë sikur organeve të tjera shtetërore, qeverisë nuk mund t'i ndërpritet mandati në kohën e luftës ose gjatë kohërave të krizave serioze. Ajo rrinë në pushtet derisa të zgjasin rrethanat e tilla të luftës dhe krizave të tjera serioze, për shkak se shteti në këto situata nuk guxon të ngelet pa organin udhëheqës të pushtetit ekzekutiv. Por është e mundur që, ani pse vetëm në aspektin teorik, mandati saj të shkurtohet në kohë të gjendjes së domosdoshme të shkaktuar nga dorëheqja ose votimi mosbesimit, me kusht që parlamenti të mbaj seancë dhe të ketë shumicën për formimin e qeverisë së re.

Ndërprerja e funksionit të ministrit nuk shkakton ndërprerjen automatike të mandatit të qeverisë. Nëse bëhet fjalë për një person të rëndësishëm politik në qeverinë e koalicionit, megjithatë, mund të vije deri te kriza e qeverisë dhe rënia e saj, për të zëvendësimit ose dorëheqjes së personit të tillë. Ministri mund të jep dorëheqje që ditën e konstituimit të qeverisë dhe, atëherë, pa asnjë debat paraprak lidhur me te, i ndërpritet funksioni. Dorëheqja i dorëzohet kancelarit, i cili e merr në dijeni, përkatësisht e aprovon, ose i dorëzohet kryetarit të qeverisë parlamentare ku dorëheqjen e konstaton parlamenti. Ministri mund të shkarkohet nga shefi qeverisë ose parlamenti mund t'ia shkurtoj besimin, në vartësi të asaj se kush e ka zgjedhur në atë funksion.

14.3. Kompetenca

Qeveria është organ i pushtetit ekzekutiv, por shprehja "ekzekutiv" sot nuk është krejtësisht i arsyeshëm dhe i saktë. Qeveria nuk zbaton, përkatësisht nuk ekzekuton vullnetin politik të një organi tjetër, për shkak se gjendja reale është e atillë që ajo vetë përcakton vullnetin politik dhe e vë atë në jetë përmes ministrive dhe shërbimeve të veta të ndryshme. Në sistemin parlamentar, qeveria është organ i pavarur me kompetenca kushtetuese, prapa së cilës qëndron shumica parlamentare. Pikërisht shumica parlamentare me mbështetjen e vet për miratimin e ligjeve të caktuara që i propozon qeveria, ia mundëson kësaj të fundit krijimin dhe zbatimin e politikës së brendshme dhe të jashtme shtetërore. Për shkak të përbërjes dhe organizimit të saj, qeveria paraqet një organ që shpejt dhe në mënyrë cilësore mund të reagoj ndaj ndryshimeve shoqërore dhe posedon kapacitete për orientim të shtetit kah zhvillimi (ose prapambetja) dhe, kësisoj, të realizoj ideologjinë e vet.

Revolucioni i Madhërishëm i vitit 1688 në **Angli**, Revolucioni në **Amerikë** në vitet 1770 dhe Revolucioni në **Francë** i vitit 1789 kanë krijuar struktura institucionale që vunë themelet e shtetit modern burokratik të shekullit XIX. Forma më e përhapur e qeverisë në Evropë pas vitit 1789 akoma ka qenë absolutizmi, në të rralla ishin qeveritë kushtetuese ose përfaqësuese, siç ishte rasti me sistemet angleze e holandeze parlamentare ose dederalizmi amerikan. Pas vitit 1818 (restaurimi dinastisë Burbon në Francë), çdo ditë e më shumë ka qenë e vështirë imponimi i absolutizmit si formë qeverisjeje ndaj një popullsie tanimë urbane e të arsimuar: monarkitë e

Evropës nisën të bëhen gjithnjë e më shumë monarki kushtetuese, rrethanë që reflektohej më së shumti në pozitën kushtetuese të qeverisë. Në **fillet e qeverisë parlamentare** në shek. XIX, mund të thuhet se aktiviteti qeverisë ka qenë i koncentruar në zbatimin e akteve të nxjerra nga organet tjera, përkatësisht nga parlamenti dhe gjyqet. Mirëpo, duke shfrytëzuar pozitën dhe të drejtat në procedurën e ligjvënies, me inicimin e shumë propozimligjeve, me pozitën dominante në debatin parlamentar dhe drejtimin e disiplinuar të shumicës parlamentare, qeveria është imponuar si krijues i vërtetë i ligjeve, jo vetëm si zbatues i tyre. Ligjet e nisura nga qeveria, në praktikë janë bërë instrumente të udhëheqjes me politikë shtetërore: ato më shumë lidhen për qeverinë sesa për parlamentin që i miraton, për shkak se ajo i shkruan, bën të mundur miratimin e tyre dhe, më pas, të njëjtat vetë i zbaton.[158]

Në shek. XX, më saktë, pas **Luftës së Parë Botërore**, dukshëm zgjerohen kompetencat e qeverisë në kurriz të parlamentit, një proces ky që ka nisur në dekadat e fundit të shekullit pararendës. Krijohet thuajse monopoli iniciativës legjislative në favor të qeverisë, në ndërkohë që parlamenti pasivizohet në pritje të pranimit dhe më pastaj edhe të miratimit të propozimligjeve të qeverisë. Në favor të forcimit të qeverisë shkon edhe fakti se në këtë kohë dhe në dekadat e fundit të shekullit pararendës, dukshëm shtohen punët e shtetit, të cilat ndryshojnë edhe karakterin e tij. **Shteti policor**, roli i të cilit pat qenë të ruaj rendin dhe qetësinë, shndërrohet në shtetin që udhëheq me proceset shoqërore, përkatësisht me shtetin që shërben si ndërmarrës dhe nismëtar. Kjo shkakton ngritjen e pushtetit dekretues (urdhërues) të qeverisë, si një organ që mund të drejtoj (udhëheq) dhe reagoj me kohë. Me ndryshimin e ndarjes klasike të pushtetit, me deformimin e saj në dobi të ekzekutivës, pushteti i parlamentit edhe formalisht (me akte juridike) ngushtohet. Kjo reflektohet në delegimin e ligjvënies në qeveri për fusha të caktuara (**Britania e Madhe**, **Italia**) ose autorizimin e saj me kushtetutë për ligjvënie në rastet e jashtëzakonshme (**Franca**, **Italia**). Paralel me sektorin e brendshëm, qeveria merr gradualisht rol kryesor edhe në sferën e politikës së jashtme: ajo lidh marrëveshje ndërkombëtare, shpall luftën dhe lidhë paqen, fiton kompetenca në situatat e gjendjes së jashtëzakonshme dhe të krizave të ndryshme etj.

Për të arritur në vendin e organin kryesor udhëheqës në shtet, nuk mjaftojnë vetëm autorizimet kushtetuese, por edhe një organizim i caktuar i qeverisë. Në këtë aspekt, qeveria është një organ autonom dhe i pavarur, i cili në bazë të kushtetuetës dhe ligjit nxjerr rregulloren për punën e vet dhe akte të tjera juridike. Me to ndërtohet hierarkia e brendshme mes kryetarit të qeverisë, nënkryetarit dhe ministrave të ndryshëm, që është kusht themelor për punë të përbashkët Qeveria krijon trupa profesional: komisione, shërbime, këshilla etj., të cilat brenda ministrive përgatisin aktet e qeverisë. Qeveria koordinon, harmonizon, drejton dhe ushtron mbikëqyrje ndaj punës së ministrive dhe organeve të tjera të administratës. Përveç kësaj, ajo kontrollon ligjshmërinë dhe arsyeshmërinë e akteve të administratës, shfuqizon dhe anulon aktet e saj, emëron dhe shkarkon funksionarët e saj.

Në planin e politikës së brendshme, qeveria përcakton dhe drejton politikën e vendit, diçka që përqafohet në të gjitha vendet me sistem parlamentar, përfshirë këtu **Francën** që ka sistem gjysmëpresidencial. Me këtë edhe formalisht është shtypur kompetenca klasike e qeverisë për ekzekutim të ligjeve dhe të politikës që përcakton parlamenti, përmes rregulloreve për zbatimin e ligjeve. Qeveria është pushtet aktiv që politikisht drejton shtetin, definon situatat, planifikon zhvillimin dhe për këtë mban përgjegjësi politike. Përkundër tërë kësaj që u tha, qeveria akoma nëpër kushtetuta definohet edhe si një organ që siguron zbatimin e ligjeve (**Zvicra**), përkatësisht si pushtet ekzekutiv që zbaton vendimet e parlamentit (**Izraeli**).

[158] Cf. më shumë në José Antonio Cheibub & Bjørn Erik Rasch, "Constitutional parliamentarism in Europe, 1800–2019". *West European Politics,* Vol. 45 No. 3 (2022), fq. 470-501.

Qeveria përcakton dhe drejton politikën e jashtme. Me kushtetutë lejohet, meqë konsiderohet e dobishme dhe e domosdoshme, që organi që mund të veproj shpejt të ketë autorizim edhe për shpalljen e gjendjes së luftës dhe rrezikut të drejtpërdrejtë nga lufta, në përgjithësi shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në të gjitha trajtat e saj, miratimin e rregulloreve të luftës, kufizoj të drejtat dhe liritë e qytetarëve, krejt kjo me qëllim të tejkalimit të një situate konkrete.

Qenësore për pozitën e qeverisë është edhe fakti që ato, çdo ditë e më shumë, kanë fituar të **drejtën për miratim të ligjeve**. Sipas ndarjes klasike të pushtetit, qeveria nxjerr akte nënligjore, më të rëndësishmet nga të cilat janë **rregulloret për zbatimin e ligjeve**. Në situatat e jashtëzakonshme, qeveria ngjitet më sipër me të drejtën për nxjerrjen e **dekreteve me fuqi ligjore** pa lejen paraprake të parlamentit, duke prodhuar ato në bazë të autorizimit të drejtpërdrejtë kushtetues. Këto dekrete me fuqi ligjore, më pastaj duhet të miratohen nga parlamenti. Si të tilla, dallohen nga legjislacioni i deleguar: këtu qeveria autorizohet nga parlamenti për nxjerrjen e **akteve me fuqi ligjore** gjatë **kohës së paqes**, përkatësisht gjatë jetës normale dhe të përditshme të shtetit. Kjo e drejtë e delegimit duhet të përcaktohet qartë me kushtetutë, për shkak se me te sovraniteti popullor (nacional) bartet nga parlamenti në qeveri, largohet nga qytetari. Kjo praktikë më së shumti asocohet me Francën, ku edhe ka lindur: sipas nenit 38 të **KFr** të 1959, aktualisht në fuqi, qeveria autorizohet për ligjvënie përmes **urdhëresave** ("pour légiférer par voie d'ordonnance") me qëllim të zbatimit (ekzekutimit) të programit politik të qeverisë. Për të ngelur në fuqi këto akte ligjore të qeverisë, ato duhet të dërgohen në parlament për miratim brenda një afati të përcaktuar. Nëse nuk dërgohen në parlament brenda afatit të përcaktuar, ose nëse parlamenti nuk miraton ligj për konformimin e tyre, atëherë urdhëresat humbin fuqinë juridike. Ndërhyrje edhe më e madhe (më e fuqishme) e qeverisë në ligjvënie është ligjvënia përmes **rregulloreve autonome**, të cilat sërish i hasim në konstitucionalizmin francez: në këto raste, sipas nenit 37.1 lidhur me nenin 34 të **KFr**, qeveria ka autorizim për nxjerrjen e akteve ligjore në të gjitha sferat shoqërore, Përveç atyre që janë shprehimisht të rezervuara për ligjet e parlamentit, siç janë: e drejta penale, zgjedhjet, organizimi i pushtetit, të drejtat e njeriut, mbrojtja, vetëqeverisja lokale, mbrojtja ambientit etj., (të përcaktuara me nenin 34 të KFr, ku përcaktohen fushat për ligjvënie parlamentare në mënyrë taksative). Këtu qeveria, praktikisht, me rregullore autonome ndryshon legjislacionin ekzistues, plotëson ligjet e parlamentit (ligjet bazë), ose miraton akte të reja me të cilat në mënyrë primare (origjinere, për herë të parë) normohen marrëdhëniet shoqërore.

14.4. Përgjegjësia e qeverisë dhe të drejtat e saj ndaj parlamentit

Si tërësi, qeveria është organ i pushtetit dhe, si një trup kolektiv, bartë përgjegjësi politike. Përgjegjësia e qeverisë para parlamentit është cilësi themelore e sistemit parlamentar. Kjo do të thotë se nuk bëhet gjykim ndaj qeverisë dhe ministrave por, në bazë të përgjegjësisë politike, mund të shqiptohet edhe sanksion politik që nënkupton **largim nga funksioni**. Secili anëtar i qeverisë, si pjesë e ekipit, ka përgjegjësi solidare para parlamentit, i cili mund të shpreh mosbesimin ndaj qeverisë, si dhe para votuesve që në zgjedhje mund të votojnë një parlament me përbërje tjetër politike dhe, për pasojë, edhe një qeveri tjetër.

Instrumentet e kontrollit ndaj qeverisë që **drejtpërdrejtë** ose **tërthorazi** mund të çojnë në konstatimin e përgjegjësisë së saj janë:

- pyetjet parlamentare;
- interpelanca;
- votimi i mosbesimit;
- këshillat/komisionet hetimore;
- hetimet parlamentare; dhe
- e drejta e buxhetit e parlamentit.

Te **votimi i mosbesimit** të qeverisë, në mënyrë të drejtpërdrejtë konstatohet përgjegjësia politike e qeverisë dhe, nëse ekziston shumica parlamentare e kundërt me qeverinë, ajo zëvendësohet. Instrumentet tjera të kontrollit parlamentar si më sipër vetëm tërthorazi mund të ndikojnë në largimin e qeverisë, atëherë kur kontrolli ka shkaktuar fillimin e procedurës së **votimit të mosbesimit** (mocioni i mosbesimit) ose **mosvotimit të besimit** (mocioni i votëbesimit) të qeverisë apo kur kryetari i qeverisë përkatësisht krejt anëtarët kanë dhënë dorëheqje.

Anëtari qeverisë ka edhe përgjegjësi politike individuale. Ministri përgjigjet për punën e vet joligjore, jooportune (jo të duhur) dhe jo mjaft të mire në resorin që drejton, për aktet e shefit të shtetit kur i ka kundërfirmosur dhe, siç u tha, edhe për punën e krejt qeverisë si trup kolektiv në tërësi. Përgjegjësinë e tij politike e konstaton parlamenti (në qeverinë parlamentare) ose kancelari (në qeverinë kancelarike), të cilët i shqiptojnë sanksionin politik – shkarkimin dhe zëvendësimin me një tjetër drejtues të resorit. Sa i përket përgjegjësisë civilo-juridike për dëmin material dhe jomaterial, anëtari i qeverisë ka status të njëjtë si çdo individ tjetër. Nga përgjegjësia penalo-juridike, ndjekjes dhe gjykimit penal, e mbron imuniteti, i cili mund të merret (tërhiqet). **Imuniteti procedural** ekziston kur mbron ministrin nga veprat penale të kryera gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare.

Qeveria dhe parlamenti reciprokisht janë në marrëdhënie të peshës dhe kundërpeshës. Përkundër instrumenteve të kontrollit parlamentar, qeveria posedon të drejta të caktuara përmes së cilave mbrohet nga parlamenti dhe ndikon në punën e tij. Ndikimi parë i qeverisë në parlament është përmes propozimit të ligjeve. Parlamenti i merr propozimet e ligjeve me qëllim që shumica parlamentare të deklarohet për to, që praktikisht do të thotë se qeveria udhëheq me vendimmarrjen në parlament.
Qeveria ka të drejtë të jep dorëheqje ose të kërcënon me dhënien e dorëheqjes nëse parlamenti nuk voton vendimin e caktuar. Në këtë mënyrë qeveria ushtron presion politik në parlament për votim të një ligji ose pikë tjetër të rendit të ditës që ka rëndësi për te. Dorëheqja ose kërcënimi me dorëheqje e shefit të qeverisë ka efekt të njëjtë sikur dorëheqja ose kërcënimi me dorëheqje i krejt qeverisë. Qeveria shfrytëzon edhe mocionin e votëbesimit të vetvetes, si mjet presioni në parlament. Për të siguruar mbështetjen e parlamentit dhe të publikut, para miratimit të ndonjë ligji kufizues (ta zëmë: ngritja e tatimeve, uljen e rrogave në sektorin publik ejt.), qeveria mund të kërkoj që parlamenti paraprakisht të votoj për besimin e saj. Më këtë hap, ajo e lidh parlamentin edhe më shumë për vete dhe politikën e saj.

Në fund, nëse bashkëpunimi politik mes parlamentit dhe qeverisë është në krizë, për çka qeveria do të humb ose veç ka humbur mbështetjen e shumicës parlamentare, atëherë ajo mund të shpërndaj parlamentin. Në të vërtetë, në këtë rast qeveria paraqitet si një organ që propozon shpërndarjen e parlamentit, kurse shefi i shtetit merr vendimin. Vendimi i shefit të shtetit mund të jetë krejt formal, kur ai në të vërtetë nuk vendos për shpërndarjen (Britania e Madhe), apo tërësisht vendim meritor, kur mund por nuk detyrohet të veproj sipas propozimit të qeverisë për shpërndarje të parlamentit (Italia). Me këtë të drejtë qeveria mënjanon kërcënimin që vjen nga parlamenti për shkurtim të besimin për qeverinë dhe dërgim të mosmarrëveshjes mes tyre për arbitrim te votuesit, të cilët mund të zgjedhin parlamentin me përbërje të njëjtë ose të ndryshme politike.

15. Qeveria e Kosovës: parimet e përgjithshme

Neni 92 i **KKos** përcakton parimet bazike institucionale dhe funksionale të qeverisë. Ky nen vendos parimet në lidhje me përbërjen e qeverisë, kufijtë në ushtrimin e funksionit të saj origjinal, si dhe përcakton në përgjithësi rolin substancial të saj në sistemin politik. Në **paragrafin e parë** të tij përcaktohet përbërja e qeverisë: ajo përbëhet nga kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat.[159] Kryeministri

[159] Kjo nënkupton se çdo vendim që në bazë të **KKos** nxirret nga qeveria, nuk mund të suprimohet nga një vendim i vetëm një anëtari të saj, apo nga ndonjë institucion apo person tjetër: kompetenca për të vendosur në çështje të paraparë me KKos

luan rolin e shefit individual të ekzekutivit kosovar.[160]Përveç kryeministrit, ekzekutivi përbëhet gjithashtu nga zëvendëskryeministrat dhe ministrat. Qeveria, pra, është një organ kolektiv, sepse përbëhet nga shumë anëtarë dhe, krejt logjikshëm, vendimet e saj merren nga një proces i votimit brenda saj. Aspekti organizativ përbën faktor që tregon për natyrën vendimmarrëse të këtij organi. Kohëve të fundit, në përvojën krahasuese nëpër botën demokratike, ekziston një rol në rritje i kryeministrave, aq shumë sa shpesh cilësohet ”presidencializim” i qeverisjes, përkundër faktit që, në kuptim organizativ, shefi qeverisë i nënshtrohet konceptit kolektiv të vendimmarrjes në të.[161] I rëndësishëm është fakti i përbërjes së qeverisjes në kuptim të këtij neni edhe përballë modelit të vet qeverisë: karakteri kolektiv i qeverisë, me ministrat dhe zëvendëskryeministrat në përbërje të tij, është gjithashtu përcaktor i rolit që kryeministri ka në tërësinë e qeverisë. Në këtë aspekt, duhet thënë që qeveria bart kompetenca që i takojnë asaj si kolektiv, por gjithashtu kryeministri kakompetenca të tij individuale në kuadër të kompetencave kushtetuese të qeverisë, siç përcaktohet qartas nga neni 94 i **KKos**.

Paragrafi i dytë i nenit 92 të **KKos** përcakton natyrën e funksionit të qeverisë, dhe përcakton kushtet mbi të cilat një funksion i tillë duhet të ushtrohet. Ky nen përcakton burimin e autorizimit të qeverisë, përkatësisht domenin funksional të saj, kufijtë e këtij domeni, i cili ka të bëjë me të qenit bartëse e pushtetit ekzekutiv. Ky është **funksioni origjinal** i qeverisë së Kosovës, i cili ushtrohet brenda kufijve kushtetues e ligjor. Ky përcaktim kushtetues nuk duhet kuptuar me ngurtësi absolute: shumë institucione të tjera të shtetit, ndër ta edhe Presidenti i Republikës, bartin kompetenca që kanë karakteristika ekzekutive, por që nuk janë të tilla dhe, në mënyrë të natyrshme, të njëjtët kanë një ”hise“ në pushtetin ekzekutiv.[162] Në të njëjtën kohë, kjo në asnjë mënyrë nuk nënkupton që këto karakteristika nga neni 92. 2 i **KKos** i vendosin institucionet e tilla në kuadër të ekzekutivit të vendit, për shkak se kompetencat e tyre nukderivohen nga kapitulli VI i **KKos** që rregullon pushtetin ekzekutiv në vend. Në të shumtën e rasteve, janë kompetenca të bartura (deleguara) si pasojë ”rritjes së shtetit administrativ”. Këtu e kemi fjalën për ato kompetenca të natyrës ekzekutive që ushtrohen nga agjencitë dhe institucionet e pavarura shtetërore, të cilat normohen me nenin 142 të **KKos.** Kompetencat që kanë karakteristika ekzekutive të cilat ushtrohen nga Presidenti i Republikës parlamentare më shumë janë relikte të së kaluarës dhe njihen me emrin ”pushteti ekzekutiv pasiv”,[163] term ky i krijuar nga **Benjamin Konstan** në kohën e Revolucionit Francez.[164] Në një republikë parlamentare, karakteristikat ekzekutive të veprimeve të shefit të shtetit lidhen me vendimmarrjen që kryesisht është zinxhirore dhe joautonome.

---

nuk mund të anashkalohet përmes një deklarate, opinioni apo konkluzioni qeveritar apo çfarëdo forme tjetër e shprehjes pa karakter detyrues dhe as ushtrimi i saj të bartet (delegohet) në individ ose institutcione të tjera. Cf. ngjashëm edhe **Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë** PL. US 1/86 I datës 14.11.1996).

160 Sipas nenit 94.4 të **KKos**, kryeministri mund të shkarkojë dhe emërojë ministra pa lejen e parlamentit, përveç atyre që kanë të bëjnë me komunitetet pakicë, ngarkimi dhe shkarkimi i të cilëve përcaktohet me dispozitën e nenit 96.5 të **KKos**. Sipas kësaj dispozite, zgjedhja e ministrave dhe zëvendësministrave nga komunitetet pakicë vendoset pas konsultimit me partitë, me koalicionet ose grupet që përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë; nëse caktohen kandidatë jashtë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, për këta ministra e zëvendësministra kërkohet miratimi formal i shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët u përkasin partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin në fjalë. Cf. për rastet e kundërta me Kosovën në Anthony King and Nicholas Allen, “Off With Their Heads’: British Prime Ministers and thePower to Dismiss”. *British Journal of Political Science*. Vol. 40 No. 2 (2010), fq. 249-278.

161 Kjo shprehje shërben për të përshkruar fenomenin ku kryeministri devijon nga vendimmarrja kolektive brenda partisë politike dhe koalicioneve eventuale, duke u bërë një forcë politike autonome që vepron jashtë kuadrit politik të partisë që drejton apo koalicionit që udhëheq. Cf. në për këtë fenomen në kontekstin e Japonisë, por i shtjelluar në apsektin krahasimor, në artikullin e Ellis Krauss and Benjamin Nyblade “Presidentialization’ in Japan? The Prime Minister, Media and Elections in Japan”. *British Journal of Political Science*. Vol. 35 No 2 (April 2005), 357-368.

162 Cf. më shumë për këtë në Thomas A. Baylis, “Presidents versus Prime Ministers: Shaping Executive Authority in Eastern Europe“. *World Politics*. Vol. 48 No. 3 (April 1996), fq. 297-323.

163 M. J. C. Vile, *Constitutionalism and the Separation of Powers*, kapitulli i trembëdhjetë (“Epilogue: The Separation of Powers and the Administrative State), fq. 285-420.

164 Andras Sajo, *Limiting the Government. An Introducion to Constitutionalism.* (CEU Press: Budapest, 1999), fq. 173-204 (ku autori jep një analizë komparative të pushtetit ekzekutiv, përfshirë edhe llojet e origjinës së tij).

Paragrafi i tretë i nenit 92 të KKs përcakton detyrimin e qeverisë përballë akteve të miratuara nga ana e Kuvendit të Kosovës, si dhe rregullon hapësirat nga ku qeveria mund të vishet me autorizime ekzekutive. Sa i përket çështjes së parë, neni 92.3 vendos detyrimin e qeverisë për të zbatuar aktet e nxjerra nga ana e Kuvendit. Në vendosjen e këtij detyrimi, që është klasik dhe me këtë identifikohet qeveria parlamentare e lindur pas revolucioneve të fundit të shek. XVIII e tutje, neni 92.3 dallon dy lloje aktesh: një, aktet juridike të formës së ligjit, dhe dy, të gjitha aktet tjera juridike të miratuara nga ana e Kuvendit. Sa i përket ligjeve, ky nen përcakton qartësisht relacionin e qeverisë si organ ekzekutiv përballë Kuvendit, si organi legjislativ i shtetit. Në këtë kuadër, qeveria është e detyruar të zbatoj ligjet e nxjerra nga ana e Kuvendit, dhe nuk ka asnjë hapësirë autoriteti prej nga mund t'i ikë një detyrimi të tillë.[165] Detyrimi i vendosur me nenin 92.3 që qeveria të zbatojë ligjet e nxjerra nga ana e Kuvendit, nuk mund të përjashtohet në asnjë mënyrë, për më tepër, as Kuvendi në kuptim të këtij neni nuk mund t'ia lejojë qeverisë që të mos e zbatojë një ligj të caktuar. Është e rëndësishme të kuptohet struktura logjike e nenit 92.3 sa i përket detyrimit të qeverisë për të zbatuar ligjet e Kuvendit: neni në fjalë nuk e përcakton detyrimin e qeverisë për zbatimin e ligjeve të Kuvendit thjeshtë si një funksion i vullnetit të këtij të fundit, por si një detyrim kushtetues të vet qeverisë. Me një fjalë, qeveria dhe Kuvendi, si dy institucione që përfaqësojnë pushtete të ndara dhe të kundërbalancuara, nuk kanë asnjë hapësirë autoriteti për të ndryshuar apo ndaluar detyrimin e zbatimit të ligjit nga ana e qeverisë, të vendosur sipas nenit në fjalë. Sa i përket çështjes së dytë, neni 92.3 përcakton detyrimin e qeverisë që të zbatoj "aktet tjera të miratuara" nga ana e Kuvendit. Në këtë aspekt, duhet thënë që termi "të gjitha aktet tjera" të miratuara nga Kuvendi, përbën një detyrim shumë të gjerë të qeverisë përballë funksionit legjislativ të Kuvendit. Termi në fjalë, prandaj, vendos detyrimin e qeverisë që të zbatojë të gjitha aktet tjera juridike, jo vetëm të ligjit, të miratuara nga ana e Kuvendit, pavarësisht se çfarë formë juridike kanë ato (p.sh. rezolutë, mocion, vendim, etj.). Ky përcaktim e bën qeverinë të detyruar që të zbatojë çdo akt juridik që mund të nxjerrë Kuvendi i Kosovës, si një trup kolektiv, dhe e zgjeron shumëfish hapësirën mbi të cilën qeveria mbanë përgjegjësinë e saj ekzekutive përballë Kuvendit.

I rëndësishëm është gjithashtu edhe përcaktimi kushtetues në këtë paragraf, sipas të cilit qeveria "ushtron veprimtari tjera brenda përgjegjësive të saj të përcaktuara me kushtetutë dhe me ligj". Një pyetje bazike që shtrohet këtu është nëse kompetencat apo pushteti i qeverisë kanë karakter statik? Bazuar në nenin 93 këtë formulim kushtetues, autoriteti ekzekutiv i qeverisë mund të ndryshoj sipas përcaktimit kushtetues dhe ligjor: gjerësia dhe masa e pushtetit të qeverisë është përcaktim i kushtetutës dhe ligjit, ashtu që edhe pushteti në fjalë mund të jetë objekt i ndryshimit konstant përmes ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore. Ky nen, thënë ndryshe, vendos detyrimin e qeverisë që t'i nënshtrohet një ligji apo një amendamenti kushtetues të miratuar në Kuvend, i cili ka prekur një kompetencë të qeverisë. Ajo, në kuptim të këtij neni, nuk mund të shtojë apo heq nga vetja kompetencat ekzekutive, për shkak se një gjë e tillë është prerogativë e funksionit kushtetutëbërës dhe ligjvënës të Kuvendit. U mor vesh, amendamentet kushtetuese të cilat i referohen rolit dhe pozitës së ekzekutivit duhet t'i nënshtrohen kufizimeve të njëjta nga neni 113 parag. 4 dhe 9, në lidhje me nenin 114 parag. 3 të **KKos**.

Paragrafi i katërt i nenit 92 të **KKos** përcakton autoritetin e qeverisë në rolin e saj si propozues i ligjeve dhe akteve të tjera juridike. Në kuptim të funksionit të saj ekzekutiv, ky neni përsërit rolin e qeverisë si një organ që vendimet e saj i nxjerrë në përputhje me procedurën dhe detyrimet substanciale të vendosura me KKos dhe ligjet përkatëse, duke vendosur njëkohësisht që vendimet e qeverisë që nuk burojnë dhe që nuk respektojnë detyrimet e dala nga dy aktet përkatëse të jenë **ipso**

[165] Si shembull krahasues, **Gjykata Kushtetuese e Lituanisë** në vendimin e saj 70/06 ka theksuar se, në bazë të kushtetutës, procedurat lidhur me përdorimin dhe tjetërsimin e pronës shtetërore duhet të parashihen me legjislacion. Një legjislacion i tillë duhet të përcaktojë qartë institucionet shtetërore që do të kenë kompetencë të transferojnë pronësinë e pronës shtetërore. Kjo gjithashtuvlen edhe për qeverinë, e cila nuk ka diskrecion të vendos për mos zbatim të dispozitave të caktuara të një ligji përkatës, përveç kur një gjë e tillë është paraparë **expressis verbis** brenda legjislacionit. Cf. **Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë** 70/06 i datës 23.05.2007).

iure të pavlefshme. Kjo dispozitë autorizon qeverinë që të ndërhyjë në procesin legjislativ përmes dy rrugëve: një, si një propozues direkt i projektligjeve si dhe iniciues i amendamentimit të tyre; dhe dy, si një organ që mund të jap opinionin e vet zyrtar për një projektligj të propozuar nga një iniciues tjetër.

Sa i përket rolit të saj në rastin e parë, qeveria është e veshur me autorizimin kushtetues për të propozuar projektligje në Kuvendin e Kosovës, apo edhe të inicioj amendamentimin e ligjeve që tanimë janë në fuqi. Në rolin e saj iniciues, në kuptim të kësaj dispozite, qeveria nuk është e kufizuar nga ndonjë procedurë e veçantë apo detyrim substancial, dhe iniciativa e saj për një projektligj është direkte, meqë e detyron në anën tjetër Kuvendin që ta procedojë të njëjtin projektligj në procedurë të miratimit parlamentar. Kjo e drejtë e qeverisë, prandaj, përbën një nga rrugët e komunikimit të saj me organin legjislativ, rrugë përmes së cilës qeveria paraqitet me të drejtën e plotë të iniciativës legjislative. Në kuptim të këtij neni, Kuvendi nuk është i obliguar në asnjë formë nga propozimi legjislativ i qeverisë, përderisa detyrimi i vetëm i Kuvendit është nxjerrja e projektligjit të propozuar nga qeveria, apo amendamentit ndaj një ligjit ekzistues, në seancë plenare për votim sipas procedurës ligjvënëse. Duhet thënë që, autorizimi i dhënë me këtë dispozitë, në një republikë parlamentare sikur Kosova, nuk përbën vetëm të drejtë por edhe përgjegjësi për qeverinë, meqë kjo e fundit nuk duhet të jap përgjegjësi politike dhe shoqërore vetëm për faktin nëse ka zbatuar një ligj të caktuar, por edhe për faktin nëse ka qenë mjaftueshëm e përgjegjshme që të inicioj miratimin e një projektligji të duhur për shtetin. Prandaj, neni 92.4 i KKos fut qeverinë në "rrethin" e përgjegjësisë legjislative, duke e bërë atë aktor aktiv sa i përket bërjes së ligjeve, dhe jo thjeshtë vetëm sa i përket zbatimit të tyre.

Sa i përket rolit të saj të dytë, neni 92.4 i **KKos** i jep të drejtë qeverisë që të jap mendimin e saj për projektligjet e iniciuara nga palët tjera të autorizuara. Në ushtrimin e kësaj të drejte, qeveria vepron si një organ kolektiv, ku procesi i dhënies së opinionit të saj i nënshtrohet votimit kolektiv në mbledhjen e saj. Në këtë kuptim, duhet thënë që opinioni i qeverisë i dhënë për një ligj të caktuar që është propozuar nga një palë tjetër e autorizuar, nuk është obligativ, dhe nuk e detyron as Kuvendin, por as iniciuesin e projektligjit. Arsyeja e dhënies së kësaj të drejte për qeverinë lidhet thjeshtë me faktin që qeveria duhet të ketë mundësinë që të jap arsyetimin lidhur me implikimet apo/dhe dështimet në zbatimin e një ligji që mund të jetë propozuar nga ana e një pale tjetër të autorizuar. Pavarësisht opinionit të qeverisë, kur projektligji në fjalë votohet në Kuvend dhe hyn në fuqi, ai bëhet i detyrueshëm për zbatim nga ana e qeverisë.

15.1. Kompetencat e qeverisë

Neni 93 i **KKos përcakton kompetencat e qeverisë, si përbërës të funksionit të saj** ekzekutiv. Bazuar në këtë nen, qeveria ushtron një mandat që buron nga **KKos**: vetëm në bazë të këtij autorizimi, ushtrimi i pushtetit ekzekutiv nga ana e qeverisë ka legjitimitet të plotë në aspektin kushtetues. Janë katër lloje të kompetencave të qeverisë: një, kompetencat në fushën e zbatimit të normave juridike dhe të ndërtimit të politikave publike sipas autorizimeve nga këto të fundit, dy, kompetencat në fushën legjislative, tre, kompetencat në fushën e emërimit të titullarëve të disa prej institucioneve të shtetit, dhe katër, kompetencat e saj në fushën e inicimit të amendamenteve kushtetuese dhe të referimit të pyetjeve gjykatës kushtetuese. Nga numërimi taksativ i 13 kompetencave të përcaktuara me nenin 93 të KKos, rezulton që numri më i madh i tyre i referohen funksionit bazik të qeverisë si një ekzekutues i akteve juridike përkatëse dhe i zbatimit të politikave publike në fushat e caktuara. Të shohim si duken të gjitha kompetencat e qeverisë si më sipër, një nga një.

Neni 93.1 i **KKos** përcakton kompetencën e qeverisë për të propozuar dhe zbatuar politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit.[166] Ky paragraf përcakton rregullën më bazike të një kompetence

[166] **Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut**, në vendimin e saj U. br. 140/99, ka theksuar se një akt i qeverisë

të zgjeruar të qeverisë, që **është** funksioni natyral i saj. Dy karakteristikat e këtij paragrafi janë: një, që ai e vendos qeverinë në pozicionin e një propozuesi të politikës së brendshme dhe të jashtme, dhe dy, në pozicionin e zbatuesit të saj. Ky paragraf, i shikuar, i izoluar nga tërësia e normave të tjera kushtetuese, jep përshtypjen që politika e brendshme dhe e jashtme e shtetit nuk vendosen nga qeveria, dhe se qeveria **është** vetëm propozuesi dhe zbatuesi i saj. Nga një vlerësim sistemor i kësaj dispozite, megjithatë, kuptimi më real është se qeveria në shumë raste **është** edhe dizajnues dhe vendimmarrës për politikat themelore të brendshme dhe të jashtme, dhe jo thjeshtë një propozues dhe zbatues i saj.[167] Koncepti që qeveria është propozuesi dhe zbatuesi i politikës së brendshme dhe të jashtme, në mënyrën në të cilën normohet në këtë paragraf, nënkupton që vendimmarrja mbi politikën e brendshme dhe të jashtme të shtetit përcaktohet përmes legjislacionit përkatës, i cili pastaj duhet zbatuar nga ana e qeverisë. Vet legjislacioni përkatës, megjithatë, lejon hapësirë shumë të gjerë në pothuajse çdo fushë të politikave publike (si në fushën e brendshme ashtu edhe në atë të jashtme), ku qeveria mund të ushtrojë diskrecionin e saj dhe të marrë vendime të pavarura. Në kuptim të këtij paragrafi, i rëndësishëm **është** fakti që "termi politikë" e brendshme dhe e jashtme nënkuptojnë tërësinë e politikave publike të shtetit që kanë objekt çështje të natyrës brenda shtetit dhe çështje të natyrës së relacioneve të shtetit të Kosovës me shtetet dhe entitetet tjera të huaja. Pozicioni i qeverisë si propozues dhe si zbatues i politikës së brendshme dhe të jashtme, në kuptim të këtij paragrafi, duhet parë brenda tërë kompetencave të institucioneve **të** tjera, meqë shumë fusha të politikave publike të fushës së brendshme dhe të jashtme janë pronë kushtetuese edhe e institucioneve **të** tjera. Kjo nënkupton gjithashtu se asnjë ligj apo rregull tjetër në lëmin e brendshëm apo të jashtëm nuk guxon të jetë në kundërshtim me këtë nen dhe me vetë natyrën e ekzekutivit në një sistem parlamentar siç është **Kosova.**

Neni 93.2 i KKos përcakton që qeveria mundëson zhvillimin ekonomik të vendit. E listuar si kompetencë, mundësimi i zhvillimit ekonomik paraqitet më shumë si një detyrim pozitiv për qeverinë. Në këtë aspekt, kompetenca e tillë e qeverisë duhet komentuar jo thjeshtë si një autorizim i qeverisë për të nxjerrë dhe zbatuar tërësinë e nevojshme të politikave publike për të mundësuar zhvillimin ekonomik të vendit, por gjithashtu edhe si një detyrim pozitiv i qeverisë për të ndjekur një kurs të tillë kushtetues. Koncepti kushtetues i mundësisë së zhvillimit ekonomik është thjeshtë thelbi i një detyrimi kushtetues të qeverisë për të plotësuar interesat bazike qytetare. Për t'iu qasur kësaj çështjeje në mënyrë më të thellë, është i nevojshëm dekonstruktimi i termit "mundësim" i zhvillimit ekonomik, i përdorur në këtë paragraf. Shikuar në aspektin e një ekonomie të tregut, koncepti kushtetues që qeveria detyrohet të "mundësoj" zhvillimin ekonomik ka shumë kontrast me konceptin e qeverisë si "zhvillues" ekonomik: ky paragraf ndërton detyrimin që qeveria vetëm të përkujdeset për ndërtimin e një ambienti ekonomik ku zhvillimi i kësaj të fundit të mund të jetë i mundshëm, përderisa kjo kompetencë nuk e "detyron" qeverinë që të luaj rolin e motorit të zhvillimit ekonomik. E shikuar në debatin ekonomik majtas apo djathtas, ky paragraf qëllimisht përcakton një detyrim shumë liberal dhe djathtist për qeverinë sa i përket zhvillimit ekonomik, meqë e detyron këtë të fundit që vetëm të ndërtoj kushtet e nevojshme ekonomike ku mundësohet zhvillimi, përderisa vet zhvillimi ekonomik bartet më shumë tek akterët tjerë, kryesisht nga ata në sektorin privat. Këtu shteti ka detyrimin e vetëm të rregullatorit të jetës ekonomike: ky paragraf logjikshëm ndërton rolin e qeverisë si një mekanizëm që instalon një ambient biznesor ku zhvillimi i ekonomisë pastaj ngelet prerogativë e vet sektorit privat, por edhe akterëve të tjerë ekonomikë që në treg veprojnë në kushte të barabarta. Këtu qeveria nuk është akteri që drejtpërdrejtë e bartë dhe e zhvillon ekonominë kombëtare, siç ka qenë dikur

me të cilën themelohen marrëdhëniet diplomatike me një shtet përkatës nuk i ka elementet e një marrëveshje ndërkombëtare që është pjesë e rendit të brendshëm juridik. Ky është një akt përmes të cilit një shtet demonstron vullnetin politik për themelimin e marrëdhënieve diplomatike me një shtet të tjetër, dhe si i tillë nuk i nënshtrohet kontrollit gjyqësor, por vetëm kontrollit politik që ushtrohet brenda kornizave të demokracisë parlamentare. Cf. **Vendim i GjykatësKushtetuese të Maqedonisë së Veriut** U.br. 140/99, i datës 14.6.2000.

[167] Roli i qeverisë në politikën e jashtme të shtetit, në kuptim të dëshmive empirike, varet shumë nga modeli i lidershipit të kryeministrit. Cf. më shumë për këtë në Juliet Kaarbo, "Prime Minister Leadership Styles in Foreign Policy Decision-Making: A Framework for Research". *Political Psychology*. Vol. 18 No. 3 (September 1997), fq. 553-581.

në sistemet socialiste dhe borgjeze të proveniencës së ekstremit të majtë dhe të djathtë, respektivisht.[168] Përveç si më sipër, ky paragraf përcakton kompetencën e qeverisë në relacion me procesin legjislativ të Kuvendit, duke vendosur që qeveria të ketë të drejtën e propozimit të projektligjeve dhe akteve tjera në Kuvend. E drejta e qeverisë për të propozuar projektligje dhe akte të tjera për miratim në Kuvend, e vendosur me këtë paragraf, përbën një nga rolet më bazike të qeverisë në një demokraci parlamentare çfarë është Kosova. Meqë në kushtet bashkëkohore të zhvillimit të shtetit, shteti ligjor ka pësuar një zgjerim të fuqishëm, shumica e politikave publike kërkohet që të shndërrohen në ligje para se ato të mund të zbatohen në jetën publike. Në këtë kuptim, praktikisht, pothuajse çdo politikë publike e qeverisë shndërrohet në të tillë pasi që ajo të ketë marrë formën e ligjit nga ana e Kuvendit. Prandaj, roli i qeverisë si propozues i ligjeve përbën hapësirën në të cilën qeveria i legjitimon dhe i legalizon në formë të ligjeve propozimet e saj për politika publike në pothuajse çdo fushë të jetës publike. Funksioni i qeverisë si propozues i projektligjeve, në anën tjetër, duhet shikuar edhe në relacion me komunikimin ndërmjet vet tri degëve të pushtetit. Në një republikë parlamentare si Kosova, qeveria është motori i propozimit të projektligjeve në Kuvend, përderisa ky i fundit luan thjeshtë një rol pasiv të kontrollit dhe të miratimit të tyre. Në këtë mënyrë, si parim, në një qeveri parlamentare, projektligjet e qeverisë të dërguara në Kuvend shërbejnë jo thjeshtë për legjitimimin e tyre parlamentar por edhe për legjitimimin e politikës publike të vet qeverisë nga përfaqësuesit e popullit të përfaqësuar në Kuvend. Në këtë praktikë, logjikshëm, qeveria është në kontroll të shumicës parlamentare e cila e ka fuqinë, në parim, për të miratuar projektligjet e propozuara nga qeveria. Prandaj, një qeverisje ekzekutive efektive, në një model demokracie si Kosova, mund të funksionojë vetëm në një relacion mirëbesimi në mes të qeverisë si propozues ligjor dhe shumicës parlamentare në Kuvend si një kontrollues dhe miratues i projektligjeve të propozuara nga qeveria. Pavarësisht se autorizimi i dhënë me këtë paragraf ka karakter thjeshtë legjislativ,[169] ai gjithashtu luan edhe një rol të fuqishëm të (mos) besimit parlamentar që ka qeveria. Ligjet e propozuara nga qeveria dhe të refuzuara nga shumica parlamentare në Kuvend mund të rezultojnë gjithashtu edhe me dorëheqjen e qeverisë, apo largimin e saj me votë mosbesimi ose mungesë të votës së besimit, meqë në një rast të tillë mungon një korrelacion pozitiv konstant në mes të propozimit të ligjeve nga qeveria dhe mbështetjes parlamentare të saj në institucionin legjislativ.

Neni 93.4 i **KKos përcakton** autorizimin e qeverisë për të nxjerr**ë** akte nënligjore dhe vendime për të zbatuar ligjet e miratuara nga Kuvendi.[170] Ky paragraf, praktikisht, vendos instrumentet juridike përmes së cilave qeveria autorizohet për të vënë në jetë detyrimet abstrakte që rrjedhin nga ligjet e miratuara nga Kuvendi. Instrumenti i tillë juridik i qeverisë mundëson që qeveria të ushtroj veprimtarinë e saj të zbatimit të detyrimeve ligjore përmes nxjerrjes së akteve juridike me fuqi nënligjore dhe akteve juridike individuale, në mënyrë që i tërë procesi i zbatimit të së drejtës të jetë juridikisht i qëndrueshëm dhe i sigurt**ë**.[171]Për të qenë në pajtim më **KKos**, autorizimi për të nxjerr**ë** akte nënligjore, megjithatë, duhet t'i

---

168 Në kuptim të mendimit juridik amerikan, hapësirat e tilla të dhëna me kushtetutë shpeshherë shihen si burime të autorizimeve kushtetuese që nuk kanë kufij, që lejojnë qeverinë të kapërcejë të ashtuquajturit kufij të pushtetit të saj vetjak. Cf. më shumë në George Sutherland, "The Internal and External Powers of the National Government". *The North American Review*. Vol. 191, No. 652 (March 1910), fq. 373-389.

169 Si shembull krahasues, **Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë** theksoi se parlamenti ka pushtet legjislativ dhe ushtron kontroll parlamentar mbi ekzekutivin. Komisioni parlamentar për Radion dhe Televizionin është shpërbërë më 1990, dhe BNTV dhe BNR janë bërë institucione tëpavarura, autonome, gjithëkombëtare dhe të ndara nga çfarëdo partie. Komisioni i përhershëm parlamentar është vetëm organ ndihmës dhe nuk ka asnjë kompetencë të nxjerrë vendime që ndryshojnë aktet e votuara në parlament, e as nuk mund të ushtrojnë pushtet ekzekutiv. Cf. **Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë** 16/95 i datës 19 shtator 1995.

170 Si shembull krahasues, **Gjykata Kushtetuese e Lituanisë** vendosi se dispozitat e një akti ekzekutiv që i mundësoi qeverisë ta caktojë shumën e premisë (shpërblimit) për kryetarin e gjykatës supreme, prokurorin e përgjithshëm dhe Auditorin Shtetëror, si dhe normat për caktimin e shpërblimeve për gjyqtarët, është në kundërshtim me kushtetutën dhe ligjet përkatëse. Cf. **Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë**, 3/95 i datës 06.12.1995.

171 **Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë** ka dhënë qëndrimin që të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me kushtetutë nuk mund të kufizohen me dispozita nënligjore të nxjerra nga ana e qeverisë dhe autoriteteve të tjera me fuqi ekzekutive. Qeveria nuk ka kompetencë të kufizojë të drejtën e pronës apo ligjin kundër konkurrencës përmes dekreteve qeveritare. Cf. **Vendim i GjykatësKushtetuese të Sllovakisë** PL.US 7/96 i datës 27 shkurt 1997.

plotësoj këto kushte:

- akti nënligjor duhet të rregulloj një fushë juridike që rregullohet përmes ligjit të nxjerr**ë** nga ana e Kuvendit;
- akti nënligjor nuk guxon të shkel**ë** një ndalesë të vënë nga ana e ligjit përkatës;
- akti nënligjor duhet të ndjek**ë** qëllimin dhe objektivat e ligjit; dhe,
- akti nënligjor duhet të ketë karakter konkretizimi të normave abstrakte të ligjit përkatës.

Nëse akti nënligjor përkatës plotëson këto katër kushte, atëherë fuqia e tij juridike buron drejtpërdrejtë nga ky paragraf i **KKos** dhe nuk ka probleme të natyrës kushtetuese. Autorizimi për të nxjerr**ë** akte nënligjore përbën një fuqi shumë të rëndësishme sublegjislative të qeverisë,[172] **përmes së cilës ajo e** juridizon procesin e zbatimit të ligjit.[173] **Në procesin e nxjerrjes së** akteve nënligjore, megjithatë, qeveria nuk lejohet që të keqpërdor**ë këtë autorizim si mënyrë e** bishtnimit të normave abstraktë të ligjit.[174] Kjo nënkupton se aktet nënligjore të qeverisë, të nxjerra sipas kushteve të mësipërme dhe sipas autorizimit të këtij paragrafi, shndërrohen në instrumente të detyrueshme ligjore për të gjithë personat që ato iu drejtohen dhe në kuptim të zbatimit të ligjit. Prandaj, në ushtrimin e autorizimit kushtetues për të nxjerr**ë** akte nënigjore, qeveria paraqitet thjesht**ë** si një aktor neutral në funksion të konkretizimit për qëllim të zbatimit të ligjeve përkatëse, dhe jo si një legjislator i pavarur.

Neni 93.5 i **KKos përcakton autorizimin e qeverisë për të propozuar buxhetin e Republikës** së Kosovës.[175] Dy janë **çështjet** që duhen veçuar n**ë** kuptim të këtij neni: një, që autorizimi për të propozuar buxhetin e shtetit, nuk përbën thjeshtë një të drejtë, por edhe një detyrim që planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve publike të ndërtohet në linjë me politikat publike të programuara për vitin e ardhshëm financiar; dhe dy, që përmes këtij autorizimi kushtetues, qeveria shndërrohet në mekanizmin që bën planifikimin financiar dhe tavanet e shpenzimeve buxhetore të tërë institucioneve shtetërore, duke pasur gjithashtu tagrin që të vendos mbi vëllimin e shpenzimeve financiare që do të ketë çdo institucion shtetëror. Natyrisht, koncepti i propozimit të buxhetit, si një autorizim kushtetues për qeverinë, **është** i kufizuar me të drejtën në pavarësi financiare të shumë institucioneve të pavarura. Prandaj, në këto raste, qeveria nuk guxon ta shfrytëzoj autorizimin kushtetues nga ky paragraf për t'i zvogëluar buxhetin e propozuar një institucioni të pavarur të shtetit.[176] Duhet thënë se autorizimi

[172] Si shembull krahasues, **Gjykata Kushtetuese e Kroacisë** gjeti se "Konkluzionet" e qeverisë janë akte që kanë të bëjnë me çështje preliminare dhe nuk janë rregullore. Ato, për pasojë, nuk mund të kontestohen përmes procedurës së kontrollit abstrakt të ligjshmërisë, gjë që ka bërë që kërkesa për t'i ato të hidhet poshtë. Cf. **Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë** U-II-1095/1995, U-II-1021/1995 i datës 27 dhjetor 1995.

[173] Si shembull krahasues, **Gjykata Supreme e Estonisë**, në vendimin e saj 3-4-1-5-2000 lidhur me vlerësimin e një rregulloreje të qeverise theksoi se ajo mund të nxjerrë rregullore përderisa ligji që i jep asaj kompetenca për të nxjerr rregullore të tilla është në fuqi; nëse ligji zëvendësohet me një ligj tjetër, qeveria gjithashtu duhet të lëshojë rregullore të re. Cf. **Vendim i Gjykatës Supreme të Estonisë** 3-4-1-5-2000, i datës 15 maj 2000.

[174] **Gjykata Kushtetuese e Moldavisë** në vendimin e saj 21/2004 ka theksuar se në pajtim me kushtetutën, qeveria nxjerr akte nënligjore (dekrete) për implementimin e ligjeve. Dekreti nr. 782-37 nuk përmban ndonjë klauzolë që thekson se cilën dispozitë ligjore do ta implementojë: duke nxjerrë një dekret të tillë, qeveria ka tejkaluar kufizimet e veta kushtetuese. Cf. **Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Moldavisë** nr. 21 i datës 2 shtator 2004.

[175] Kushtetuta e parë që ka përcaktuar të drejtën ekskluzive të qeverisë për propozim të buxhetit është ajo e **Spanjës** e vitit 1812, e njohur si **Kushtetuta e Cadiz**-it. Më pas, gati të gjitha kushtetuta moderne kanë ndjekur, pak a shumë, logjikën e njëjtë, e cila mund të përmblidhet për sa vijon: qeveria ka rol të veçantë në propozimin e buxhetit dhe në ushtrimin e këtij roli ajo duhet të jetë neutrale. Përcaktimi dhe shpërndarja e shpenzimeve publike, në parim, nuk i nënshtrohet kontrollit gjyqësor kushtetues përveç nëse një gjë e tillë shkel parimin e barazisë në mes të institucioneve kushtetuese apo të drejtat dhe liritë fondamentale njerëzore. Shpenzimi i buxhetit dhe mbikëqyrja e tij, ndërkaq, mund të jetë vetëm i mëpastajmë. Për këtë qëllim, zakonisht formohen organizata të veçanta nga ana e parlamentit, siç është zyra e auditorit të përgjithshëm, apo gjykatat e ndryshme të auditimit (Franca). Cf. më shumë për këtë në Andras Sajo, *Limiting the Government. An Introducion to Constitutionalism*, fq. 158-159 & 190-193.

[176] Si shembull krahasues, **Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë** në vendimin 01/10 theksoi se ekzekutimi i buxhetit shtetëror i është besuar këshillit të ministrave. Në ushtrimin e kësaj kompetence, qeveria duhet të veprojë në pajtim me ligjin për buxhetin shtetëror, ashtu siç është aprovuar nga parlamenti, por nuk ka të drejtë ta ndryshojë atë. Një dispozitë ligjore e cila i jep kom-

kushtetues për të propozuar buxhetin e shtetit, sipas këtij paragrafi, nuk përbën detyrim për Kuvendin për ta miratuar buxhetin e propozuar nga qeveria. Për më tepër, Kuvendi bart**ë** tagrin kushtetues që ta ndryshojë një propozim të tillë, dhe që ta miratojë një buxhet sipas versionit të tij. Megjithatë, koncepti që propozimi i buxhetit të bartet nga qeveria ndërton në këtë të fundit edhe detyrimin që t'i përgjigjet publikut për racionalitetin e ndarjeve buxhetore dhe legjitimitetin e shpërndarjes së një buxheti të tillë.

Neni 93.6 i KKos përcakton autorizimin e qeverisë për të udhëzuar dhe mbikëqyrur punën e organeve të administratës publike. Në kuptim të këtij neni, ndërlidhur edhe me nenin 101 të KKos, sistemi kushtetues i Kosovës përcakton një ndarje vertikale të pushtetit ekzekutiv. Pjesa e sipërme e pushtetit ekzekutiv përbën nivelin politik të qeverisë, nën të cilën gjendet e varur tërë administrata shtetërore, e cila përbën, në anën tjetër, nivelin civil të pushtetit ekzekutiv. Kjo ndarje vertikale në mes të nivelit politik dhe atij civil të pushtetit ekzekutiv përbën një karakteristikë të sistemeve kushtetuese demokratike që ofrojnë hapësirë për zhvillim të një strukture shtetërore që nuk ka prirje dhe afiliim partiak, dhe që përbën pjesën e përhershme, meritore, profesionale dhe civile të shtetit, që është shërbimi civil. Prandaj, ndarja vertikale e pushtetit ekzekutiv, e cila bëhet në bazë të modelit të emërimit (varësisht, pra, nëse emërimi në nivelin përkatës është politik apo civil), përbën një garancion shumë të rëndësishëm demokratik në kuptim të strukturës së pushtetit ekzekutiv, meqë mundëson që një strukturë e përhershme shtetërore, e ashtuquajtura administratë shtetërore, të mund të ushtrojë funksionin e saj në mënyrë të përhershme dhe pa qenë e prirur politikisht në ushtrimin e funksionit të saj.

Në këtë kuptim, neni 93.6 i KKos vendos autorizimin e qeverisë për të udhëzuar dhe mbikëqyrur punën e administratës shtetërore, e cila **është** një përbërje institucionale e varur në pikëpamje strukturore për qeverinë, mirëpo në substancë paraqet një trup mekanizmash jopolitik. I rëndësishëm në kuptim të këtij neni është dekonstruktimi i termit udhëzim dhe mbikëqyrje për administratën. Termi "udhëzim" i shfrytëzuar nga paragrafi në fjalë i referohet autorizimit të qeverisë për të drejtuar punën e administratës shtetërore. Megjithatë, ky term nënkupton që qeveria është e autorizuar të veproj vetëm në kuadër të normatives juridike që përcakton garancionet dhe funksionet e shërbimit civil. Megjithëse, termi "udhëzim" që buron nga ky paragraf i jep fuqi qeverisë që të vendos drejtimet e politikave publike nga duhet të veprojë administrata publike, ajo nuk ka të drejtë që të njëjtës t'ia ndryshojë funksionin e saj ligjor të zbatimit profesional dhe të pavarur të së drejtës. Në këtë kuptim, koncepti i qeverisë si "udhëzues" i administratës publike nënkupton autorizimin e saj që t'ia përcaktoj objektivat dhe metodat e zbatimit të politikave publike që miraton qeveria, por që funksioni zbatues i administratës shtetërore të jetë profesional dhe i pavarur, jashtë ndikimeve me karakter politik apo partiak të qeverisë. Termi "mbikëqyrje", ndërkaq, i shfrytëzuar nga paragrafi në fjalë, i referohet autorizimit të qeverisë për të kontrolluar rregullsinë dhe racionalitetin e veprimtarisë së administratës publike, gjë që nënkupton se kjo e fundit jep përgjegjësi ligjore përballë qeverisë. Duhet thënë që koncepti "mbikëqyrje" i shfrytëzuar nga ky paragraf nuk jep asnjë autorizim për ta marrë në përgjegjësi politike administratën publike, por thjesht për ta kontrolluar rregullsinë ligjore dhe efiçencën e veprimtarisë së saj civile. Natyrshëm, koncepti i "mbikëqyrjes" **së** administratës publike nënkupton edhe autorizimin e qeverisë për të shkarkuar bartësit e administratës shtetërore në rast se ata duhen veshur me përgjegjësi juridike sa i përket kryerjes së funksionit të tyre, e gjitha kjo brenda garancioneve të një shërbimi civil, të pavarur, profesional dhe meritor, sipas nenit 101 të KKos.

Neni 93.7 i **KKos** përcakton autorizimin e qeverisë për të udhëzuar veprimtarinë dhe zhvillimin e **shërbimeve publike**. Në kontrast me nenin 93.6 të KKos, ky paragraf vendos një lloj detyrimi për qeverinë për të udhëzuar dhe për të zhvilluar shërbimet publike të shtetit. Është e rëndësishme të thuhet që shërbimet publike janë shërbimet bazike shtetërore që çdo shtet është në detyrim t'ia ofrojë qytetarëve të

petencë kështillit të ministrave kompetenca të cilat sipas kushtetutës i takojnë parlamentit, është deklaruar kundërkushtetues. Cf. **Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë** 01/10 i datës 31 mars 2010.

saj, dhe që zakonisht përfshijnë shërbimet publike në fushën e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes civile të qytetarëve, apo edhe shërbimet publike në fushën e rritjes së standardit jetësor të qytetarëve. Një dekonstruktim i kësaj norme juridike thjesht nuk përcakton vetëm autorizimin e qeverisë për të "udhëzuar" shërbimet publike, dhe për të dizajnuar politikat e nevojshme publike, por përbën edhe një lloj detyrimi për të organizuar dhe bartur shërbimet publike themelore. Termi "udhëzon veprimtarinë dhe zhvillimin" e shërbimeve publike, gjuhësisht, shpreh gjithashtu edhe detyrimin kushtetues që qeveria ka për të bartur dhe garantuar se shteti ofron një numër bazik të shërbimeve publike për qytetarët dhe personat juridik të saj. Një interpretim i tillë natyrshëm nënkupton se qeveria nuk ka mundësi të heq dorë nga dhënia e shërbimeve publike në fushat bazike, meqë kjo përbën jo thjeshtë një autorizim por një detyrim kushtetues. Gjerësia dhe lloji i shërbimeve publike që "duhet" të ofroj shteti përmes qeverisë, nuk janë përcaktim i këtij neni, dhe ato janë substancë e vet substancës së politikave publike që ndërton qeveria.

Neni 93.8 i **KKos** përcakton kompetencën e qeverisë për t'i propozuar presidentit të republikës emërimet dhe shkarkimet e të gjithë shefave të misioneve diplomatike të Kosovës. Në kuptim të këtij paragrafi, qeveria e ushtron këtë autorizim në kompozicion kolektiv, përderisa Presidenti i Republikës nuk është i detyruar që të pranoj propozimin e qeverisë. Në kuptim të këtij paragrafi, megjithatë, Presidenti i Republikës nuk mund të emërojë dikë shef të një misioni diplomatik të Kosovës në vendet e huaja nëse ajo/ai nuk ka ardhur në formë të propozimit të qeverisë. Ky autorizim, prandaj, i mundëson qeverisë që të luaj funksionin e një filtruesi të personave që mund të ushtrojnë detyrën e **shefit të misionit diplomatik**, përderisa e luan të njëjtin funksion edhe në kuptim të shkarkimit të shefave të misioneve diplomatike. Thënë shkurtimisht, ky paragraf i mundëson qeverisë që të ushtrojë funksionin e ushtrimit të politikës së jashtme të vendit në bashkërendim me Presidentin e Republikës, meqë supozimi ekziston që pas një konsensusi në mes të qeverisë dhe Presidentit të Republikës sa i përket shefave të misioneve diplomatike, këta të fundit do të kenë një linjë të përgjegjësisë politike edhe përballë qeverisë. Përgjegjësia e tillë politike përballë qeverisë e shefave të misioneve diplomatike nënkupton se ata duhet të sillen si "të bindur" ndaj drejtimeve të politikave që ata marrin nga qeveria e shtetit. Autorizimi i dhënë nga ky paragraf për qeverinë varet shumë nga fakti nëse Presidenti i Republikës është një "i dëgjuar" i qeverisë, dhe/apo nëse Presidenti vjen nga i njëjti kamp politik. Në rastin e tillë, ky autorizim kushtetues për qeverinë shndërrohet në mjet të kontrollit direkt dhe të kërkimit të përgjegjësisë politike nga shefat e misioneve diplomatike. Në të kundërtën, nëse Presidenti i Republikës luan rolin e një kundërshtari/kundërbalancuesi të qeverisë, ky autorizim i qeverisë është shumë i vështirë për t'u përdorur nga ajo si e vetme në kërkimin e përgjegjësisë politike nga shefat e misioneve diplomatike të Kosovës në shtetet e huaja.

Nenet 93.9 dhe 93.10 të KKos e autorizojnë qeverinë që të marrë pjesë në procesin e **amendamentimit të kushtetutës** dhe të **kontrollit kushtetues të akteve përkatëse juridike me fuqi juridike më të ulët se KKos**. Në rastin e parë, qeveria është e autorizuar nga ky nen që të inicioj procesin e amendamentimit të kushtetutës, dhe të ofrojë një amendament kushtetues për Kuvendin, duke e luajtur kështu rolin e palës së autorizuar. Natyrisht, amendamenti i propozuar duhet që pastaj t'i nënshtrohet procedurës së kontrollit parlamentar dhe të votimit, që shikuar në terma praktikë lë shumë pak hapësirë për qeverinë si e vetme që të imponojë votimin e një amendamenti në procedurën me shumicën e dyfishtë dhe të kualifikuar të votimit. U mor vesh, kjo nënkupton se kontrolli kushtetues preventiv i amendamenteve në fjalë bëhet sipas dispozitave të nenit 113.3 (4) dhe 9 lidhur me nenin 144.3 të Kushtetutës. Në rastin e dytë, qeveria autorizohet që të referojë çështje para gjykatës kushtetuese, në të cilin rast, referimi i çështjeve dhe shqyrtimi i tyre nga gjykata bëhet në kuadër të juridiksionit gjeneral dhe special të përcaktuar nga paragrafët 2 dhe 3 të nenit 113 të **KKos**. Me autorizimin për të ngritur çështje pranë gjykatës kushtetuese, qeveria është e veshur me të drejtën e kontestimit të kushtetutshmërisë së ligjeve të miratuara nga Kuvendi, që duhet parë si një kompetencë që e bën këtë të fundit mjaft të fuqishme në kuptim të relacionit të saj me organin legjislativ dhe produktin e tij legjislativ. Përveç juridiksionit nga dy paragrafët e cekur më sipër të nenit 113 të KKos, në praktikë ka pasur raste kur qeveria e ka vënë në lëvizje **GJKRKS** edhe për çështje tjera jashtë atyre të parapara me këta dy paragrafë. Kështu, ta zëmë, qeveria ka kërkuar interpretim të dispozitave kushtetuese lidhur me caqet dhe vëllimin e imunitetit të zyrtarëve të lartë shtetërorë në **Republikën**

e Kosovës, gjë që nuk lidhet fare me kontrollin kushtetues të normës në fjalë. Në këtë rast, **GJKRKS** ka njohur të drejtën e qeverisë për të ngritur çështje kushtetuese para saj, jashtë paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 113 të KKos, përkatësisht ia ka njohur të drejtën e qeverisë për të ngrehur para gjykatës çdo çështje që ajo konsideron vetë se ka natyrë kushtetuese. Në fakt, këtë të drejtë, **GJKRKS** e kishte njohur më herët në "rastin Pacolli", kur qeveria kishte kërkuar një sqarim nga **GJKRKS** lidhur me atë nëse deputetët duhej të rrinin në sallë me rastin e votimit për President të Republikës në të ardhmen. Qeveria këtë kërkesë e kishte bërë në mbështetje të nenit 93.10 të Kushtetutës që thotë se qeveria "mund të referoj çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese". Më një fjalë, në këtë rast qeveria ka kërkuar në njëfarë mënyre "mendim këshillëdhënës" apo "mendim interpretativ", i cili nuk njihet formalisht në sistemin kushtetues kosovar. U mor vesh, kjo nuk është kështu me vendet tjera, ta zëmë, me **Bullgarinë, Italinë** etj., për çka folëm më sipër kur diskutuam të njëjtën kompetencë lidhur me Presidentin e Republikës: siç u pa me atë rast, neni 84.9 dhe neni 93.10 i **KKos** kanë përmbajtje tërësisht identike dhe përdorin formulim tërësisht identik gjuhësor.

Në kuptim të nenit 93.11 të **KKos**, qeveria ushtron edhe funksione të tjera ekzekutive, të cilat nuk u janë caktuar organeve tjera qendrore ose lokale. Ky nen përcakton të ashtuquajturën listë të kompetencave ekzekutive të "papërmendura" nga kushtetuta, të cilat, si parim, nuk supozohet t'i jenë dhënë në mënyrë eksplicite ndonjë institucioni tjetër shtetëror. Në bazë të këtij paragrafi, qeveria autorizohet që të gëzojë çdo kompetencë kushtetuese që nuk i është përcaktuar në mënyrë eksplicite një institucioni tjetër shtetëror.[177] Megjithatë, ekzistojnë gjashtë kushte që duhen plotësuar në mënyrë që qeveria të mund të gëzoj një kompetencë të "papërmendur" sipas nenit 93.11: një, që kompetencat të cilën qeveria pretendon ta gëzoj të mos i jetë dhënë në mënyrë eksplicite një institucioni tjetër shtetëror; dy, që kompetenca të ketë karakter ekzekutiv, dhe të mos i përkas funksioneve tjera shtetërore (gjyqësore, legjislative); tre, që kompetenca në fjalë të mos jetë një instrument themelor për arritjen e një objektivi kushtetues që ka funksioni i një organi tjetër shtetëror; katër, që kompetenca në fjalë të mos dëmtojë raportin në mes të tre pushteteve, dhe që të mos rrezikoj modelin e ndarjes horizontale dhe vertikale të pushteteve; pesë, që kompetenca e tillë të jetë legjitime, në kuptim të ndalesave që vendosen nga ana e kushtetutës sa i përket pushtetit ekzekutiv, dhe, gjashtë, që kompetenca e tillë të mos ndërhyj në garancionet e qeverisjes lokale që përcaktohen me kushtetutë, dhe të drejtat e vetëqeverisjes që gëzojnë komunat.

15.2. Kompetencat e kryeministrit

Neni 94 i **KKos** përcakton kompetencat individuale të kryeministrit të cilat duhen parë në dritën e funksionit të tërësishëm të qeverisë dhe kompetencave të saj të përcaktuara me nenin 93. Prandaj, kompetencat e kryeministrit të përcaktuara me këtë nen janë suplement funksional i nenit 93, dhe përbëjnë listën e autorizimeve/detyrimeve që kryeministri bart brenda vet autoritetit të qeverisë së shtetit. Duhet thënë se kompetencat individuale të kryeministrit janë tregues i rolit të tij brenda qeverisë, dhe i vet karakterit të qeverisë në aspektin vendimmarrës, por edhe i përgjegjësisë dhe pozitës së anëtarëve tjerë të qeverisë përballë kryeministrit dhe institucioneve jashtë terenit ekzekutiv[178] Duhet thënë se, megjithatë, në një demokraci parlamentare, kryeministrat janë pa diskutim aktorët praktikisht shumë të rëndësishëm të tërë sistemit politik, por në veçanti të degës ekzekutive.[179]

Neni 94 i **KKos** përcakton 10 kompetenca për kryeministrit, në një paragraf të vetëm, megjithëse shumica nga to nënkuptojnë autoritet shumë më të gjerë sesa ai i shkruar në këtë nen. Prandaj, t'i komentojmë të

[177] Krahaso me argumentin se si dispozitat e tilla mund të rrezikojnë konceptin që pushteti ekzekutiv është i limituar. Cf. më shumë në George Sutherland, "The Internal and External Powers ofthe National Government", fq. 373-389.

[178] Cf. në përgjithësi për këtë në R. A. W. Rhodes and Patrick Dunleavy, Prime Minister, Cabinetand Core Executive (Macimallan: Basingstoke, Hants. 1995).

[179] Eoin O'Malley, "The Power of Prime Ministers: Results of an Expert Survey". *International Political Science Review/Revue internationale de science politique*. Vol. 28 No. 1 (2007), fq. 7-27.

gjitha kompetencat e kryeministrit në mënyrë individuale. **Pika e parë** përcakton kompetencën e kryeministrit për të përfaqësuar dhe udhëhequr qeverinë. Kompetenca e përcaktuar me këtë paragraf e rregullon pozitën e kryeministrit brenda tërë organizatës së qeverisë. Në njërën anë, ky paragraf i jep fuqi kryeministrit që të jetë përfaqësues i qeverisë, përderisa, në anën tjetër, gjithashtu e vendos kryeministrin në rolin e udhëheqësit të qeverisë. Të shohim individualisht secilën nga këto dy koncepte kushtetuese. Sa i përket autorizimit të përfaqësimit të qeverisë, ky paragraf e vendos kryeministrin në rolin e përfaqësuesit të qeverisë,[180] si në kuptimin e brendshëm institucional, ashtu edhe atë të jashtëm: kryeministri është i vetmi zyrtar i autorizuar që të komunikojë qëndrimin e qeverisë brenda strukturës institucionale të pushtetit ekzekutiv, por edhe në relacion me dy degët e tjera të pushtetit shtetëror. Është i rëndësishëm fakti që roli përfaqësues i kryeministrit, si i tillë, është më shumë rol formal, meqë kryeministri thjeshtë komunikon me palët institucionale në bazë të vendimeve të marra nga qeveria në nivelin e përcaktuar procedural.

Roli përfaqësues i kryeministrit, megjithatë, duhet parë në kontekst të llojit të vendimit/kompetencës mbi të cilën vepron qeveria. Kjo sepse, në shumë raste, KKos përcakton kompetencë kolektive për qeverinë, në të cilin rast kryeministri është i detyruar të përfaqësojë qeverinë si një kolektiv zërash, dhe jo të jetë përfaqësues i zërit vetjak individual. Sa i përket termit ”udhëheq” me qeverinë, ky paragraf i jep një autorizim shumë të fuqishëm individual pozitës së kryeministrit në tërë modelin vendimmarrës të qeverisë, por edhe në vet strukturën e saj qeverisëse.[181] Koncepti ”udhëheq” i shfrytëzuar në këtë dispozitë i referohet autorizimit kushtetues të kryeministrit për të drejtuar dhe menaxhuar tërë qeverinë. Shikuar thjesht në aspektin juridik kushtetues, koncepti ”udhëheqje” i vënë në këtë paragraf e shndërron kryeministrin në shefin e qeverisë, dhe me këtë i jep kryeministrit karakterin e të parit dhe udhëheqësit të qeverisë së vendit. Në këtë aspekt, kryeministri nuk është i pari ndërmjet të barabartëve, por është shefi individual i tërë qeverisë, të cilit anëtarët e tjerë të qeverisë i përgjigjen politikisht.[182] Koncepti ”udhëheqje” sipas kësaj dispozite, i jep kryeministrit të paktën katër prerogativa qeverisëse ndaj anëtarëve të qeverisë dhe ndaj tërë aparatit ekzekutiv: një, që drejtimi i qeverisë është fuqi ekzekutive që i takon kryeministrit, dhe asnjë anëtar i qeverisë nuk lejohet që ta kontestojë politikisht një urdhër të dhënë nga kryeministri; dy, që udhëzimet e dhëna nga kryeministri janë kushtetutshmërisht të obligueshme për anëtarët e qeverisë, dhe ata janë të përgjegjshëm politikisht për ndjekjen e tyre; tre, që menaxhimi i qeverisë është përgjegjësi individuale e kryeministrit, dhe ai përgjigjet individualisht përballë Kuvendit dhe institucioneve tjera për veprimtarinë e qeverisë së tij, dhe katër, që udhëzimet e dhëna nga kryeministri përbëjnë drejtime politikash që duhen ndjekur nga tërë aparati institucional i qeverisë, dhe jo thjesht nga anëtarët politik të qeverisë. Ky normim juridik i pozitës së kryeministrit sendërtohet dhe fuqizohet edhe me paragrafët e mëposhtëm të këtij neni, të cilët i shpjegojmë në vijim.

Duhet thënë në fund se pavarësisht që koncepti ”udhëheqje”, i cili është atribut kushtetues i kryeministrit, e pozicionon kryeministrin në një relacion kushtetues shumë të fuqishëm dhe i mundëson që të jetë shef individual i tërë qeverisë,[183] pozita reale e kryeministrit varet shumë edhe nga modeli i koalicionit parlamentar që e ka bërë zgjedhjen e tij. Në rastet e koalicioneve parlamentare, siç është rasti me **modelin parlamentar të shtetit të Kosovës** i cili përbën pothuajse situatën më normale mbi të cilën një qeveri mund të ndërtohet,[184] kryeministri praktikisht është i varur nga interesat e partnerëve

[180] Për situatat kur kryeministri ngarkohet edhe me rolin e një lideri unifikues, cf. më shumë në Frank Stark, “The Prime Minister as Symbol: Unifier or Optimizer?” *Canadian Journal of Political Science/Revue canadienne de science politique.* Vol. 6 No. 3 (1973), fq. 514-515.

[181] Cf. këtë me kushtëzimet në kontekstin e sistemit kushtetues italian, në Donatella Campus and Gianfranco Pasquino, Gianfranco, “Leadership in Italy: The Changing Role of Leaders in Elections and in Government”. *Journal of Contemporary European Studies.* Vol. 14 No. 1 (2006), fq. 25- 40.

[182] Cf. këtë me modelin e qeverisë ku kryeministri është **i pari ndërmjet të barabartëve**, në Patrick Weiler, *First Among Equals: Prime Ministers in Westminster Systems* (George Allen & Unwin: Sydney, 1985), fq. 74 dhe 85-87.

[183] Kjo shkon shumë ngjashëm me linjën e modelit japonez të qeverisë, ku e tërë qeveria varet substancialisht për kryeministrin. Shih: Robert C. Angel, “Prime Ministerial Leadership in Japan: Recent Changes in Personal Style and Administrative Organization”. *Pacific Affairs*. Vol. 61 No. 4 (Winter 1988-1989), fq. 583-602; Cf. gjithashtu edhe fjalimin e Uillson, në Woodrow Wilson, “Leaderless Government” *The Virginia Law Register* Vol. 3 No 5 (September 1897), fq. 337-354.

[184] Cf. një rast krahasues në Sona Golder Nadenichek Sona, “Pre-Electoral Coalition Formation in Parliamentary Democracies”

të koalicionit të tij, ashtu që menaxhimi/drejtimi i anëtarëve të partnerëve të koalicionit është pothuajse praktikisht tepër i vështirë.[185]

Pikat dy dhe tre të nenit 94 të **KKos** përcakton që kryeministri siguron që të gjitha ministritë e qeverisë veprojnë në pajtim me politikat e qeverisë, si dhe siguron zbatimin e ligjeve dhe politikave të përcaktuara të qeverisë. Këto dispozita e veshin kryeministrin me përgjegjësinë e garantimit që ministritë, të cilat janë organet kryesore administrative të qeverisë, veprojnë në përputhje me politikat e qeverisë, garancion ky që mundëson që ministritë të jenë të varura institucionalisht dhe praktikisht nga kryeministri dhe qeveria që kryesohet nga ai. Kjo përgjegjësi e kryeministrit, në anën tjetër, mund të shihet edhe si e drejtë e tij që të marrë në përgjegjësi kushtetuese ministritë e qeverisë së tij, nëse ato nuk ndjekin kursin e politikave të përcaktuara nga qeveria. Përveç përcaktimit të detyrimit të kryeministrit për të siguruar që ministritë ndjekin linjat e politikave të përcaktuara nga qeveria, këto dispozita gjithashtu veshin kryeministrin me përgjegjësinë e sigurimit që legjislacioni në fuqi dhe politikat e qeverisë zbatohen në përgjithësi, dhe jo thjesht nga ministritë përkatëse. Përgjegjësia e vënë me nenin 94.3 të **KKos**, praktikisht, e bën kryeministrin përgjegjësin individual për kontrollimin/sigurimin që ligjet dhe politikat publike që hyjnë në fushëveprimin e qeverisë të zbatohen në përgjithësi nga të gjitha institucionet relevante.[186]

Duhet thënë këtu që koncepti ”siguron” i shfrytëzuar nga të dy paragrafët e mësipërm i referohet përgjegjësisë por edhe të drejtës së tij të pakontestuar që të kërkoj përgjegjësi kushtetuese, por edhe t’i udhëzoj në mënyrë të detyrueshme, ministritë e qeverisë së tij, dhe të gjithë aparatin administrativ të varur nga qeveria me qëllim që të zbatojnë politikat dhe ligjet që janë detyrim i qeverisë. Shikuar më thellë, koncepti ”siguron” i përdorur këtu, ka këto karakteristika juridike: një, që kryeministri është i veshur me përgjegjësinë individuale për t’i kërkuar përgjegjësi kushtetuese ministrive dhe të gjitha mekanizmave administrativ të varur nga qeveria, sa i përket detyrimit të tyre për të zbatuar politikat publike dhe legjislacionin përkatës; dy, që të gjitha ministritë dhe mekanizmat tjerë administrativë e shkarkojnë detyrimin e tyre kushtetues për zbatimin e politikave publike dhe ligjeve tek kryeministri, dhe i raportojnë këtij të fundit mbi progresin në këtë fushë; tre, që kryeministri është përgjegjës individualisht, në emër të qeverisë, përballë Kuvendit dhe shoqërisë sa i përket funksionit kushtetues të qeverisë për zbatimin e ligjeve dhe politikave shtetërore në fushën ekzekutive, dhe katër, që të gjithë anëtarët e qeverisë dhe shefat e institucioneve tjera ekzekutive të varura tek qeveria, detyrohen sipas kushtetutës t’i përgjigjen udhëzimeve të kryeministrit sa i përket procesit të zbatimit të ligjeve dhe politikave publike nën kompetencën kushtetuese të qeverisë. Duhet thënë që termi ”siguron” i shfrytëzuar në këtë dispozitë, përfshin vetëm autorizimin e kryeministrit për të siguruar dhe kontrolluar zbatimin e mekanizmit institucional që është sipas KKos i varur për qeverinë dhe kompetencat e saj të përcaktuara me KKos.[187] Kjo nuk përbën në asnjë rast autorizim për kryeministrin që të njëjtën fuqi ta ushtroj përballë **institucioneve të pavarura** dhe atyre që i takojnë degëve tjera të pushtetit shtetëror. Kjo dispozitë, thënë ndryshe, përbën elementin më substancial që e plotëson autoritetin e kryeministrit si udhëheqës i qeverisë.[188]

Sipas nenit 94.4 të **KKos**, kryeministri është i autorizuar që të ndërrojë anëtarët e qeverisë, pa pasur nevojë për pëlqimin e Kuvendit, megjithëse kompozicioni i parë i qeverisë duhet të emërohet në

British Journal of Political Science. Vol. 36 No. 2 (April 2006), fq. 193-212.

185 Cf. Laver, Michael Laver, “Governmental Politics and the Dynamics of Multiparty Competition’. *Political Research Quarterly*. Vol. 61 No 3 (2008), fq. 532-536.

186 Cf. Eoin O’Malley, “The Power of Prime Ministers: Results of an Expert Survey” *International Political Science Review/Revue internationale de science politique*. Vol. 28 No 1 (2007), fq. 7-27.

187 Cf. me konceptin e një qeverie pa lider, në Woodrow Wilson, “Leaderless Government”, fq. 337-354.

188 Cf. për të njëjtin argument në rastin anglez, në Anthony King and Nicholas Allen, “Off With Their Heads’: British Prime Ministers and thePower to Dismiss”, fq. 249-278; John D. Huber and Cecelia Martinez-Gallardo, “Replacing Cabinet Ministers: Patterns of Ministerial Stability in Parliamentary Democracies”. *The American Political Science Review.* Vol. 102 No. 2 (2010), fq. 169-180.

Kuvend si trup kolektiv qeverisës. Shikuar në aspektin struktural, kjo pikë e përcakton mekanizmin përmes së cilit kryeministrit i mundësohet që të ushtrojë funksionin e tij si udhëheqës i qeverisë. Në anën tjetër, garantimi i autorizimit kushtetues që kryeministri të ndërrojë një ministër jashtë kontekstit parlamentar të dhënies së pëlqimit, vendos garancionin që kryeministri të mund të ushtrojë kontrollin e brendshëm të qeverisë së tij dhe të kërkimit të përgjegjësisë politike ministrave të tij jashtë kontekstit të kontrollit dhe/apo kushtëzimit parlamentar. Kërkimi i përgjegjësisë politike ministrave të tij mund të bëhet mbi shumë baza, siç mund të jenë: performanca, konceptet ideologjike, qasja dhe/ose qëndrimi mbi politikat publike etj.[189]

Autorizimi i dhënë kryeministrit me nenin 94.4 të **KKos** ka këto karakteristika juridike: një, që kryeministri ka në të drejtën e tij individuale, i pakushtëzuar nga ndonjë institucion brenda apo jashtë tij, që të ndërrojë një ministër të tij, dhe që vendimi i tij për këtë çështje të ketë efekt direkt në shkarkimin e ministrit.[190] dy, që vendimi i kryeministrit për ndërrim të një ministri të mos ketë nevojë të jetë i arsyetuar mbi bazën e të cilës kryeministri e merr një vendim të tillë, dhe që kjo natyrisht shihet si një e drejtë e plotë e kryeministrit për të marrë në përgjegjësi politike ministrat e tij; tre, që kompetenca e kryeministrit për ndërrim të një ministri të mos ketë nevojë për miratim nga Kuvendi, çfarë e bën pozitën e kryeministrit si shefin e pakontestuar të qeverisë dhe kompozicionit të saj kolektiv; katër, në ushtrimin e një të drejte të tillë, kryeministri ushtron edhe detyrën e tij si udhëheqës i qeverisë, dhe si garantues i funksionimit të saj sipas kompetencave kushtetuese; dhe pesë, në vendosjen për një çështje të tillë, nuk kërkohet ekzistimi i ndonjë rrethane të veçantë pasojë e së cilës të jetë vendimi i kryeministrit për ndërrim të ministrit.

Autorizimi i kryeministrit sipas neni 94.4 e plotëson fuqishëm rolin e tij si udhëheqës i qeverisë, meqë i jep mundësinë kushtetuese që të ndërrojë një ministër në rast se ky i fundit nuk i përgjigjet politikisht për veprimet e tij kryeministrit. Autorizimi për të ndërruar një ministër, e bën kabinetin qeveritar të varur në mënyrë të plotë nga kryeministri, dhe praktikisht, koncepti i një qeverie kolektive dobësohet fuqishëm.[191] Megjithëse qeveria vazhdon të ketë karakter kolektiv, dhe një procedurë parimisht kolektive të vendimmarrjes, mekanizmi që kryeministri mund të shfrytëzojë sipas nenit 94.4 në ndërlidhje me nenin 94.1 të KKos, i bën praktikisht anëtarët e qeverisë të detyruar që të ndjekin përcaktimin e kryeministrit gjatë procesit të vendimmarrjes kolektive. Në rastin e kundërt, kryeministri mund të shfrytëzojë të drejtën e tij kushtetuese sipas këtij paragrafi për ndërrim të ministrave të ”padëgjueshëm”.

Kjo karakteristikë kryeministrore e qeverisë, prandaj, lirshëm sjellë tek konstatimi që modeli kushtetues i qeverisë së shtetit, sipas nenit 93 dhe nenit 94 të KKos, ka tendencë të plotë të ”kryeministrizimit” të qeverisë, ku kryeministri paraqitet si figura themelore kushtetuese që udhëheq dhe drejton praktikisht dhe në pikëpamje kushtetuese qeverinë e shtetit. Kryeministrizimi i qeverisë, sipas këtyre dy neneve, rezulton në një model qeverisjeje ku përgjegjësia kolektive e qeverisë përballë Kuvendit shndërrohet realisht në përgjegjësi individuale të kryeministrit përballë Kuvendit dhe tërë shoqërisë. Prandaj, në kuptimin kushtetues, kryeministri ka rolin e shefit të pakontestuar të qeverisë, në të cilin rast i njëjti është i veshur me mekanizmin e mjaftueshëm kushtetues për t’i kërkuar ministrave të tij përgjegjësi kushtetuese dhe politike pa asnjë kushtëzim nga ana e Kuvendit, gjë që juridikisht mundëson që tërë anëtarët e qeverisë të jenë të varur institucionalisht dhe politikisht për kryeministrin.

---

189 Cf. për këtë të fundit, në Anthony King and Nicholas Allen, “Off With Their Heads’: British Prime Ministers and thePower to Dismiss”, fq. 249-278; Patrick Weiler, *First Among Equals: Prime Ministers in Westminster Systems*, fq. 74, 85-87.

190 **Gjykata Kushtetuese e Hungarisë**, duke analizuar karakteristikat kryesore të statusit juridik të zyrtarëve qeveritarë theksoi se zyrtarët qeveritarë mbajnë poste publike; statusi i tyre rregullohetme ligj dhe jo me kontrata private. Emërimi dhe shkarkimi i tyre bëhet në bazë të vendimeve administrative. Prandaj korniza ligjore duhet të jetë e qartë sa i përket vendimeve për emërim apo shkarkim të zyrtarëve qeveritarë. Cf. **Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë** nr. 8/2011i datës 18.2.2011.

191 Ndërlidhe këtë me argumentet nga: R. K. Alderman and J. A. Cross, “The Reluctant Knife: Reflections on the Prime Minister’s Powers of Dismissal”. *Parliamentary Affairs.* Vol. 38 No. 4 (Autumn, 1985), fq. 387-407.

Duhet thënë që modeli kryeministror i qeverisë, megjithatë, është praktikisht i varur nga **lloji/modeli i koalicionit qeverisës** mbi bazën e të cilit ndërtohet qeveria në Kuvend në një rast të caktuar dhe se kompetencat kushtetuese sipas nenit 94 të KKos mund që të mos i lejojnë praktikisht kryeministrit që të udhëheq me anëtarët e qeverisë apo edhe t'i ndërrojë ata nëse nuk janë nga kampi i tij politik. Logjika e koalicionit parlamentar mbi të cilën është ndërtuar qeveria, prandaj, në aspektin praktik përcakton edhe pozitën faktike të kryeministrit në qeveri, që në shumë raste mund të mos i lejojë kryeministrit gëzim të plotë të kompetencës sipas nenit 94.1 dhe nenit 94.4 të KKos. Kjo është kështu në veçanti sa i përket anëtarëve të qeverisë nga komunitetet joshumicë: neni 96 parag. 3 dhe 5 të KKos e bëjnë të qartë se ministrat e komunitetit joshumicë, të cilët hyjnë në koalicion qeverisës **per constittutionem**, nuk mund të ngarkohen pa pëlqimin e partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë. E njëjta vlen, **mutatis mutandis**, edhe për shkarkimin e tyre për faktin se përbërja e qeverisë në çdo kohë duhet të reflektoj kategorinë kushtetuese të demokracisë konsociacionale të sanksionuar në sferën e përbërjes së ekzekutivit kosovar në nenin 96 të KKos, në veçanti paragrafët e saj 3 dhe 5.

Pikat 5, 6 dhe 7 të nenit 94 të KKos përcaktojnë kompetenca për kryeministrin në fushën e kryesimit dhe emërimeve të larta, si dhe në lidhje me këshillimin në fushën e inteligjencës së shtetit. Pika e pestë përcakton që kryeministri është kryesuesi i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, që është një organ i përcaktuar me KKos. Roli i kryeministrit sa i përket kryesimit të Këshillit të Sigurisë nuk nënkupton të drejtën e tij për të qeverisur apo udhëhequr me të në kuptimin detyrues.[192] Koncepti "kryesim" i shfrytëzuar në këtë dispozitë i referohet udhëheqjes së mbledhjeve të Këshillit të Sigurisë, dhe të drejtës për të moderuar sesionet e tij. Megjithëse në rolin e tij kryesues, kryeministri sipas këtij paragrafi vihet në krye të një organi shumë të fuqishëm dhe të rëndësishëm të politikës së sigurisë së shtetit. Në këtë kontekst, kompetenca për të kryesuar Këshillin e Sigurisë përkthehet në njëfarë forme në një autorizim për të shërbyer si një ombrellë e politikave të sigurisë së shtetit, sidomos atyre që lidhen me gjendjet e sigurisë në kohë krizash. Pika e gjashtë e nenit 94.6 të **KKos** përcakton kompetencën e kryeministrit për të emëruar Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Në kuptim të kësaj dispozite, kryeministri gëzon kompetencën individuale që të emërojë Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, që është një autorizim shumë i fuqishëm sa i përket drejtimit të njërit prej institucioneve kyçe të sigurisë së shtetit. Kjo kompetencë e kryeministrit, natyrshëm, përcakton karakterin e përgjegjësisë së drejtpërdrejtë që **Drejtori i Përgjithshëm i Policisë** ka përballë kryeministrit dhe, natyrshëm, vendos edhe linjën e përgjegjësisë "politike" që ky pritet të ketë përballë tij. Duhet thënë që, pavarësisht që në një demokraci të brishtë, kjo kompetencë mund të shpie në politizim të policisë së shtetit, përgjegjësia e Drejtorit të Përgjithshëm përballë kryeministrit i shkon logjikës që polica e shtetit të ketë një linjë të drejtpërdrejtë dhe efiçente të përgjegjësisë ndaj strukturës më të lartë ekzekutive të vendit.

Pavarësisht faktit që **KKos** ia veshë kryeministrit të vendit kompetencën e emërtimit të **Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë**, kontrolli i drejtpërdrejtë i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë nga ana e kryeministrit nuk mund të konsiderohet të jetë vendosur me këtë nen të Kushtetutës. Neni në fjalë, në të njëjtën kohë, nuk autorizon kryeministrin që të ketë mundësinë e shkarkimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, gjë që e cila rregullohet me ligj të veçantë për policinë e Kosovës. Me një fjalë, kryeministri nuk e bartë të drejtën e shkarkimit të **Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë** sipas konstruksionit të normës së vënë në nenin 94.6 të **KKos**, por sipas normës ligjore. Një mundësi e tillë për kryeministrin parashihet në nenin 39.1 të **Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë** të datës 2 mars 2012. Në këtë nen flitet për mundësinë e shkarkimit të Drejtorit të Përgjithshëm vetëm në raste të caktuara, njëri prej të cilëve është "për shkak të performancës jo të mirë të dokumentuar" (neni 39.1.6 i Ligjit). Kjo

[192] Si shembull krahasues, **Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë** theksoi se qeveria është e obliguartë kërkojë miratim paraprak nga parlamenti për çfarëdo përdorimi të forcave të armatosura të Gjermanisë. Ky prerogativ rrjedh nga një traditë e gjatë kushtetuese që i daton nga **Kushtetuta e Vajmarit** e vitit 1918. Fushëveprimi i saktë dhe modalitetet e pjesëmarrjes së parlamentit në këtëfushë duhet të përcaktohen me ligj (**Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë,** No. 1 BvR 1595/92; 1BvR 1606/92, i datës 14 korrik 1994).

nënkupton se akti i kryeministrit për shkarkim mbi këtë bazë dhe mbi çdo bazë tjetër ligjore i nënshtrohet kontrollit gjyqësor të ligjshmërisë pranë Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore me seli në Prishtinë (në kuadër të procedurave mbi konfliktin administrativ). Pastaj, u mor vesh, vendimi i **Gjykatës Themelore** (GJTH) mund të goditet me ankesë në **Gjykatë të Apelit** (GJAP) kurse vendimi i kësaj të fundit mund të goditet në **GJSKos** me mjete të jashtëzakonshme të goditjes. Në fund, sipas kërkesës individuale të palës së autorizuar, mund të ketë kontroll të kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese. Në vijim për sa më sipër, ky akt i kryeministrit për emërim të drejtorit të përgjithshëm mund t'i nënshtrohet kontrollit politik të Kuvendit, si çdo akt tjetër i qeverisë. Kjo nënkupton se ky emërim mund të jetë objekt interpelance e vlerësimi politik në kuadër të aktiviteteve të rregullta të Kuvendit. Në të njëjtën kohë, vendimi i kryeministrit për shkarkim mund të shkoj edhe në **GJKRKS** për kontroll të kushtetutshmërisë, konform nenit 113. 2 (1) të KKos.

Neni 94.7 i **KKos** përcakton relacionin e kryeministrit me Presidentin e Republikës sa i përket çështjeve të inteligjencës së shtetit. Ky nen përcakton që kryeministri ka kompetencë të këshillohet me Presidentin e Republikës në lidhje me çështjet e inteligjencës. Dekonstruktimi i këtij neni rezulton në këto nënkuptime juridike: një, që kryeministri ka të drejtë dhe detyrë që të konsultohet me presidentin e republikës sa i përket çështjeve të inteligjencës së shtetit; dy, neni në fjalë lë hapësirë të nënkuptimit që kryeministri nuk ka autorizim të vendos në lidhje me çështjet e inteligjencës pa konsultim paraprak me presidentin e republikës; tre, që kryeministri ka autoritet që të përgjigjet në lidhje me politikën e inteligjencës së shtetit, përgjegjësi të cilën duhet ta shkarkoj edhe përballë Kuvendit. Në bashkëlidhje me këtë nen, neni 94.8 i **KKos** përcakton kompetencën e kryeministrit që, së bashku me **Presidentin e Republikës**, të emërojë Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), që nënkuptohet të jetë një kompetencë e ndarë me Presidentin e Republikës. Autorizimi i dhënë me nenin 94.8 të KKos, në anën tjetër, ndërton linjën e përgjegjësisë së dyfishtë që të tre funksionarët e **AKI-së** kanë përballë kryeministrit dhe presidentit dhe, anasjelltas, fjala "këshillim" e përdorur në pikat 7 dhe 8 të këtij neni nënkupton se duhet të ekzistoj pëlqimi i Presidentit të Republikës në mënyrë që veprimet e ndërmarra në zbatim të këtyre dy paragrafëve të konsiderohen si veprime kushtetuese.

Neni 94.9 i KKos përcakton udhëzimin kushtetues që kryeministri të këshillohet me Presidentin e Republikës sa i përket zbatimit të politikës së jashtme të shtetit. Kjo dispozitë, në njërën anë, vendos detyrimin që kryeministri të këshilloj Presidentin e Republikës sa i përket zbatimit të politikës së jashtme të shtetit, dhe në anën tjetër, vendos përcaktimin kushtetues që kryeministri të jetë zyrtari i qeverisë që zbaton politikën e jashtme të shtetit në kuptim të rolit kushtetues të qeverisë në këtë fushë. Natyrshëm, zbatimi praktik i politikës së jashtme nga ana e qeverisë dhe, sipas udhëzimeve të kryeministrit, në kuptim të kësaj dispozite, kryhet nga ana e një organi të posaçëm administrativ (ministrisë) brenda qeverisë që i përgjigjet kryeministrit.

Konteksti i këshillimit me Presidentin e Republikës sa i përket zbatimit të politikës së jashtme të shtetit, sipas këtij neni, vendos një kuptim detyrues që zbatimi i politikës së jashtme të shtetit nga ana e qeverisë të bëhet duke pasur parasysh opinionin e Presidentit të Republikës. Termi "këshillim" i shfrytëzuar nga kjo dispozitë duket sikur nuk ka natyrë detyruese sa i përket zbatimit të opinionit të Presidentit të Republikës, për shkak se, në fund, sipas nenit 93.1 të KKos qeveria "propozon dhe zbaton politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit". Në fund, pika dhjetë përcakton kompetencën e kryeministrit për të ushtruar çdo lloj detyre/autorizimi tjetër të përcaktuar me KKos dhe ligje përkatëse. Në këtë kuptim, duhet thënë se pozicioni i kryeministrit mund të fuqizohet edhe më tej përmes kompetencave shtesë që i përcaktohen atij me legjislacionin përkatës nga ana e Kuvendit. Kompetencat shtesë që mund t'i vishen kryeministrit sipas këtij paragrafi, megjithatë, mund të vendosen me ligj vetëm nëse plotësohen kushtet si në vijim: një, që kompetencat shtesë mos të interferojnë me kompetencat kushtetuese të kryeministrit sipas nenit 94, në kuptim të zvogëlimit të mundshëmtë tyre; dy, që kompetencat shtesë të kryeministrit të jenë të fushës ekzekutive, në kuadër të funksionit kushtetues të qeverisë sipas nenit 93 të KKos; tre,

që kompetencat shtesë të mos ndërhyjnë në garancionet kushtetuese të kompetencave të institucioneve tjera të përcaktuara me KKos dhe, katër, që kompetencat shtesët'i përshtaten funksionit udhëheqës të kryeministrit në kuadër të qeverisë, si organ ekzekutiv i përcaktuar me **KKos**.

15.3. Zgjedhja e qeverisë

Neni 95 i **KKos** përcakton procedurën e zgjedhjes së qeverisë. Procedura e përcaktuar me këtë nen, e para, përcakton edhe llojin kushtetues të qeverisë dhe, e dyta, luan një rol në përcaktimin e modelit të demokracisë parlamentare që ka Kosova. Kjo nuk nënkupton thjeshtë që qeveria është produkt indirekt i popullit të përfaqësuar në Kuvend nga përfaqësuesit e tyre, por gjithashtuedhe atë se ajo është produkt i një konsensusi të gjerë të partive parlamentare për një kabinet qeverisës të ndërtuar mbi bazën e tillë.[193] Neni 95 i KKos, prandaj, përcakton procedurën që kalon nga momenti i përfundimit të çertifikimit të rezultateve zgjedhore të zgjedhjeve parlamentare e deri tek miratimi i opsionit përfundimtar tëpropozimit për kryeministër dhe kabinet qeveritar.

Neni 95.1 përcakton që pas zgjedhjeve parlamentare, Presidenti i Republikës i propozon Kuvendit kandidatin për kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar qeverinë. Katër janë momentet themelore kushtetuese që duhen sqaruar nëkuptim të këtij neni. **Një**, emërimi i qeverisë lidhet me përfundimin e procesit të zgjedhjeve parlamentare, çfarë flet për faktin se mandati i qeverisë është i lidhur strukturalisht me mandatin e Kuvendit. Zgjedhjet parlamentare për Kuvend konsiderohen të përfunduara, apo të certifikuara, kur ato të jenë certifikuar nga organi kushtetues përgjegjës për organizimin e zgjedhjeve parlamentare, pas përfundimit të cilitdo proces gjyqësor të rregullt mbi rregullsinë zgjedhore, dhe pasi që të jenë shpërndarë dhe pranuar mandatet edeputetëve (duke përfshirë momentin e betimit të tyre). Kur ky moment kohor të ketë arritur, Presidenti i Republikës, sipas detyrimit të nenit 95.1, obligohet që ta propozojë kandidatin për kryeministër. **Dy**, në kuptim të nenit në fjalë, Presidenti i Republikës është i detyruar që ta përmbushë obligimin kushtetues të propozimit të kandidatit për kryeministër kur tëketë arritur momenti kohor i përshkruar në pikën e mësipërme. Ky obligim i Presidentit të Republikës nuk mund të tejkalohet apo të shtyhet. Presidenti, sipas nenit 95.1, propozon kandidatin për kryeministër në konsultim me partinë apo koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar qeverinë.Termi "konsultim" i shfrytëzuar në këtë paragraf, paraqet detyrim kushtetues për presidentin, dhe nënkupton obligimin e saj/tij që propozimin për kandidatin për kryeministër ta bëjë në përputhje me kërkesën e partisë/koalicionit përkatës. Duhet thënë që, në kuptim të këtij paragrafi, termi "në konsultim me" nuk i jep asnjë të drejtë Presidentit të Republikës që ta neglizhoj apo ndryshoj kandidatin e propozuar nga partia/koalicioni në fjalë. Detyrimi në fjalë është një obligim që Presidenti i Republikës e ushtron në cilësinë e funksionit si kreut të shtetit dhe nuk mund të ushtrojë diskrecion në një fushë të tillë. Prandaj, termi "në konsultim me", sipas Nenit 95.1, e detyron Presidentin e Republikës që të procedojpasivisht me kandidaturën e preferuar nga partia/koalicioni fitues. Në të kundërtën,Presidenti i Republikës do të shkelte përcaktimin kushtetues të efektit direkt që duhet të kenë zgjedhjet parlamentare mbi kompozicionin e qeverisë pasuese, përderisa detyrimi i presidentit për të propozuar kandidatin për kryeministër është një funksion ku Presidenti i Republikës nuk është i autorizuar që ta zgjedhë apo ta refuzoj kandidatin e preferuar të partisë/koalicionit përkatës. **Tre**, neni 95.1 përcakton që propozimi i Presidentit të Republikës për kandidatin për kryeministër, të bëhet pas konsultimit të partisë/koalicionit fitues që ka "shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar qeverinë". Praktikisht, në rast se një parti politike ka fituar votat e mjaftueshme që e vetme të emërojë qeverinë në Kuvend, i takon asaj e drejta për t'ia dhënë emrin e kryeministrit të propozuar te presidenti. Megjithatë, në rast se shumica e nevojshme për të formuar qeverinë bartet nga një koalicion parazgjedhor përkatës, është koalicioni përkatës që ia bën propozimin e tij te Presidenti i Republikës në lidhje me kandidaturën për kryeministër.[194] Termi "koali-

[193] Cf. më shumë për këtë në Daniel Diermeier, Hülya Eraslan and Antonio Merlo, "A Structural Model of Government Formation". *Econometrica,* Vol. 71 No. 1 (January 2003), fq 27-70.

[194] Cf. me mënyrën e funksionalizimit të kësaj kompetence nga monarkët, në C. Morgan, "Selecting a Prime Minister". *The*

cion", në kuptim të këtij paragrafi, i referohet një koalicioni parazgjedhor,[195] jo një koalicioni paszgjedhor, kur disa parti politike apo nisma qytetare kanë garuar me një listë të përbashkët deputetësh për Kuvendin e Kosovës. Arsyetimi i argumentit të fundit lidhet me faktin që ky nen përcakton që kandidatura rrjedhë nga partia apo koalicioni që "ka fituar" votat e nevojshme. Pra, termi "ka fituar" i referohet një gjendjeje ku një koalicion parazgjedhor ka garuar me një listë të përbashkët të kandidatëve për deputetë, dhe jo një koalicioni që mund të lindë "pas" konstituimit të Kuvendit. Duhet thënë gjithashtu se termi "shumicën e votave" i referohet shumicës së ulëseve në Kuvend, dhe jo votave qytetare/popullore, meqë ka mundësi që një parti/koalicion që ka fituar shumicën e ulëseve në Kuvend të mos ketë edhe shumicën popullore të votave. Ky paragraf, prandaj, i referohet shumicës së ulëseve në Kuvend, që praktikisht i bie shumicës së deputetëve në Kuvend. Megjithatë, pyetja është se çfarë do të ndodhte nëse në Kuvend nuk ka asnjë parti/koalicion parazgjedhor që ka shumicën e nevojshme për të formuar qeverinë, dhe se kujt duhet drejtuar Presidenti i Republikës për t'ia kërkuar kandidaturën që duhet propozuar për kryeministër? Paragrafi në fjalë nuk jep shpjegim se çfarë duhet bërë në një situatë të tillë. Megjithatë, sikur del logjikshëm se, në një rast të tillë, Presidenti Republikës duhet ta konsultoj partinë/koalicionin parazgjedhor që ka fituar shumicën e votave për të formuar qeverinë për të marrë emrin e kandidatit që ai do ta propozonte për kryeministër në Kuvend. **Katër**, në konsultimin e partisë/koalicionit që ka fituar shumicën e nevojshme për të formuar qeverinë, Presidenti i Republikës nuk ka autorizim të kërkoj edhe përbërjen e qeverisë që kandidati në fjalë do të propozoj në Kuvend. Autorizimi/përgjegjësia e Presidentit të Republikës lidhet thjesht dhe vetëm me momentin e kërkimit të emrit të kryeministrit, jo të anëtarëve të kabinetit qeveritar, që ky i fundit do t'i përfshij në kabinetin e tij qeverisës. Duhet thënë që, në këtë rast, në kuptim të këtij paragrafi, Presidenti i Republikës nuk lejohet të negocioj për emrin e kandidatit që propozon partia/koalicioni fitues. Ky i fundit nuk bartë asnjë detyrim për të dhënë sqarime apo për ta arsyetuar kandidatin për kryeministër para Presidentit të Republikës.

Neni 95.2 i **KKos** përcakton se hapi i dytë pas propozimit të Presidentit të Republikës të kandidatit për kryeministër, ky i fundit duhet që të sjell në Kuvend, jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë, përbërjen e qeverisëpër miratim.[196] Në kuptim të kësaj dispozite, përcaktimi i propozimit për përbërjen e qeverisë është e drejtë e plotë e kandidatit për kryeministër të propozuar nga ana e Presidentit të Republikës, dhe që një përcaktim i tillë i kompozicionit të qeverisë duhet të jetë rezultat i vet aranzhmanit konsensual të koalicionit/partisë që ka numrin e nevojshëm të votave për të emëruar qeverinë në Kuvend.[197]

Neni 95.3 **KKos** përcakton që qeveria konsiderohet e emëruar në Kuvend, nëse ajo merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.[198] Termi "shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit" i referohet shumicës së votave të tërë trupit të Kuvendit prej 120 anëtarësh, që në aspektin praktik i bie të jetë 61 deputetë. Miratimi i qeverisë së propozuar nga kandidati për kryeministër, prandaj, kërkon një shumicë absolute që rrallëherë mund të ndërtohet thjesht dhe vetëm nga një

Australian Quarterly. Vol. 36 No. 2 (June 1964), fq. 35-43.

195 Cf. më shumë në Sona Nadenichek Golder, "Pre-Electoral Coalition Formation in Parliamentary Democracies". *British Journal of Political Science*. Vol. 36 No. 2 (April 2006), fq. 193-212; Shih gjithashtu se mbi çfarë bazash zakonisht ndërtohen koalicionet paraelektorale, në Marc Debus, "Pre- Electoral Commitments and Government Formation". *Public Choice*. Vol. 138 No. 1-2 (January 2009), fq. 45-64.

196 Roli i kandidatit të kryeministrit në këtë rast, i ashtuquajturi **formatori i qeverisë**, është tejet i rëndësishëm për modelimin e qeverisë në kuptim të resurseve humane. Për një analizë komparative mbi këtë çështje, cf. Hanna Bäck, and Patrick Dumont, "Making the First Move: A Two-Stage Analysis of the Role of Formateurs in Parliamentary Government Formation". *Public Choice*. Vol. 135 No. 3-4 (January 2008), fq. 353-373.

197 Cf. me rastin japonez, në Robert C. Angel, "Prime Ministerial Leadership in Japan: Recent Changes in Personal Style and Administrative Organization". *Pacific Affairs*. Vol. 61 No. 4 (Winter 1988-1989), fq. 583-602.

198 Si shembull krahasues, **Gjykata Kushtetuese e Lituanisë** ka dhënë qëndrimin që programi i qeverisë është obligues për të për gjatë gjithë periudhës gjatë së cilës është në pushtet qeveria. Qeveritë e reja paraqesin programet para Seimas (Kuvendi i Lituanisë) me qëllim që të fitojnë fuqinë e veprimit. Aprovimi nga Seima i programit të qeverisë shpreh besimin ndaj qeverisë për periudhën sa Seima është në pushtet. Me rastin e dorëheqjes së qeverisë, programi i njëjtë nuk është e domosdoshme të aprovohet nga Seima (**Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë** Nr. 19/97 i datës 10.1.1998).

parti e vetme politike. Prandaj, neni 95.3, në ndërlidhje me konceptin politik mbi të cilin ndërtohet sistemi kushtetues i vendit, parapërcakton që qeveria të jetë e ndërtuar mbi bazën e një koalicioni prej më shumë se sa një partie, meqë, logjikshëm, asnjë parti politike nuk do të ishte në gjendje në një rrethanë normale të bartte një numër të tillë votash e vetme. Koncepti i një qeverie koalicioni, që sendërtohet praktikisht me këtë nen, nuk ka të bëjë thjesht me faktin e formimit të qeverisë nga më shumë se një parti politike, por me bashkëjetesën dhe balancimin konstant që ndodhë mes partnerëve të koalicionit gjatë bashkëqeverisjes.[199]

Neni 95.4 i **KKos** përcakton që nëse përbërja e qeverisë e propozuar nga kandidati i caktuar për kryeministër nuk merr numrin e nevojshëm të votave, atëherë Presidenti i Republikës detyrohet që brenda dhjetë ditësh të emërojë një kandidat tjetër për kryeministër sipas së njëjtës procedurë. Neni 95.4 gjithashtu përcakton se nëse as herën e dytë kandidati i nominuar për kryeministër nuk arrin të gjej mbështetjen e nevojshme në Kuvend, Presidenti i Republikës shpall zgjedhjet e parakohshme parlamentare, të cilat duhet të organizohen jo më vonë se 40 ditë nga dita e shpalljes së tyre. Ky nen, prandaj, lë të kuptohet se, në rast se Kuvendi është i pasuksesshëm dy herë radhas për të zgjedhur qeverinë, **ipso iure** shterren mundësitë për të kërkuar një kandidat të tretë apo një përbërje të tretë të qeverisë. Në këtë kuptim, ndalesa kushtetuese që të kalohet në një tentativë të tretë për propozim të kandidatit të ri për kryeministër, dhe një përbërje të qeverisë rrjedhimisht, arsyetohet me logjikën se partia/koalicioni fitues të ketë mundësinë stabile për të propozuar një kandidat për kryeministër të cilin do të jetë natyrshëm i prirë për ta mbështetur në Kuvend gjatë mandatit të tij. Duhet thënë që, në kuptim të nenit 95.4, nuk është e lejuar që kandidati për kryeministër që caktohet nga ana e Presidentit të Republikës të vije nga një proces konsultues me një parti/koalicion që nuk e ka shumicën e ulëseve në Kuvend. Kjo, prandaj, e bën ndalimin që kandidati për kryeministër të zgjidhet nga një parti/koalicion që nuk e ka shumicën në Kuvend. Sa i përket rezultatit të zgjedhjeve të parakohshme, e njëjta procedurë e zgjedhjes së kandidatit për kryeministër dhe e miratimit të qeverisë duhet ndjekur sërish. Prandaj, neni 95.4 nuk lejon ndonjë përjashtim apo procedurë më të lehtë të zgjedhjes së qeverisë pas zgjedhjeve të parakohshme, dhe e lejon nenin 95.1, nenin 95.2 dhe nenin 95.3 që të jenë të vetmet procedura mbi të cilat zgjidhet qeveria që duhet të dal pas zgjedhjeve të parakohshme. Në kuptim të nenit 95.4, në rast se nuk ka mundësi që të zgjidhet një qeveri edhe herën e dytë, procedura juridike e përcaktuar me këtë nen vazhdon të jetë mënyra e cila e rregullon situatën kur dështon miratimi i kandidatit për kryeministër në tentativën e dytë.

Neni 95.5 i **KKos** përcakton që nëse kryeministri jep dorëheqje, apo nëse për çfarëdo arsye ulësja e tij mbetet e lirë, qeveria bie, dhe Presidenti i Republikës procedon me caktimin e kandidatit për kryeministër sipas neneve të mësipërme, dhe miratimi i qeverisë ndjekë të njëjtën procedurë. Në kuptim të nenit 95.5, qeveria bartet nga kryeministri, dhe shkarkimi, dorëheqja apo mbetja e ulëses së kryeministrit vakante, sjell **ipso iure** pasojën e konsiderimit të qeverisë si të shkarkuar. Në një rast të tillë, procedura e zgjedhjes së qeverisë ndiqet sipas neneve të mësipërme. Duhet thënë që në kuptim të këtij neni, është kryeministri ai që e ndërton relacionin me Kuvendin sa i përket zgjedhjes së parë pas zgjedhjeve të kabinetit të ri qeverisës.

Neni 95.6 i KKos përcakton që anëtarët e qeverisë japin betimin para Kuvendit pas miratimit të qeverisë nga ana e Kuvendit. Ky nen, prandaj, lë të kuptohet që mandati i qeverisë fillon në momentin kur qeveria/anëtarët e saj të jenë betuar në Kuvend, dhe jo në momentin e miratimit të qeverisë nga kjo e fundit.

---

199 Cf. Michael Laver, "Governmental Politics and the Dynamics of Multiparty Competition". *Political Research Quarterly*. Vol. 61 No. 3 (September 2008), fq. 532-536. Cf. gjithashtu këtë model, dhe krahaso me atë italian të koalicioneve qeverisëse dhe stabilitetit qeverisës, në Donatella Campus, and Gianfranco Pasquino, "Leadership in Italy: The Changing Role of Leaders in Elections and in Government". *Journal of Contemporary European Studies.* Vol. 14 (April 2006), fq. 25-40; Cf. lidhur me atë se mbi çfarë bazash ndërtohen koalicionet dhe ndarja e ministrive ndërmjet anëtarëve të koalicionit, në Takanori Adachi, and Yasutora Watanabe, "Ministerial Weights and Government Formation: Estimation Using a Bargaining Model" *Journal of Law, Economics, & Organization.* Vol. 24 No. 1 (May 2008), fq. 95-119.

15.4. Ministritë dhe përfaqësimi komuniteteve

Neni 96 i KKos përcakton strukturën e brendshme të qeverisë, si dhe rregullon mënyrën e organizimit të saj dhe mekanizmit që e përcakton një rregullim të tillë. Ky nen gjithashtu përcakton edhe rezervimin e vendeve në qeveri për **përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë**, si dhe garanton aspektet procedurale që duhet të rezultojnë në një qeveri shumëetnike.
Neni 96.1 përcakton se ministritë dhe organet tjera ekzekutive themelohen, sipas nevojës, për kryerjen e detyrave brenda kompetencave të qeverisë. Në këtë kuptim,ky nen përcakton që njësitë administrative më të përgjithshme në kuadër të qeverisë janë ministritë, të cilat në fakt në natyrën e tyre institucionale janë organe administrative që ushtrojnë zbatimin e së drejtës dhe politikave shtetërore. Neni 96.1, gjithashtu, përcakton detyrimin që funksioni i ministrive apo organeve tjera më të ulëta se to, të jetë në kuadër të kompetencave të qeverisë sipas nenit 93 të KKos.Sipas kësaj që cekëm, ministritë ndalohet të marrin kompetenca që nuk hyjnë në kuadrin e kompetencave të qeverisë.

Është e rëndësishme të thuhet që termi ”organe të tjera ekzekutive” i referohet çdo strukture institucionale ekzekutive e cila është e nevojshme për të mundësuar që qeveria të ushtrojë funksionin e saj ekzekutiv bazuar në kompetencat nga neni 93 i KKos. Organet ekzekutive, natyrshëm, mund të themelohet vetëm në kuadër të mandatit kushtetues të qeverisë, dhe janë të varura për këtë të fundit.

Neni 96.2 i KKos përcakton numrin e anëtarëve të qeverisë, dhe mënyrën e rregullimit të tyre. Ky nen ndjekë një model të hapur sa i përket numrit të anëtarëve të qeverisë, duke vendosur që numri i anëtarëve të qeverisë përcaktohet me aktin e brendshëm të saj. Në këtë kuptim, janë tri komente që e shoqërojnë këtë normë kushtetuese. **Një,** që numri i anëtarëve të qeverisë, sipas këtij neni, është i hapur, dhe mund të vendoset nga çdo qeveri sipas nevojave të saj. Kjo nënkupton që pavarësishtkompetencave të qeverisë, është vet qeveria që vendos mbi numrin e anëtarëve të saj dhe pozicionin e tyre brenda kabinetit të qeverisë. E drejta për të shtuar apo zvogëluar numrin e anëtarëve të qeverisë, prandaj, përbën një hapësirë ku vet qeveria vendos për gjerësinë e kolektivit të saj sipas nevojave apo/edhe politikës së distribuimit të vendeve për partnerët e një koalicioni qeverisës. **Dy**, që përcaktimi i numrit të anëtarëve të qeverisë bëhet me anë të një akti të brendshëm të vet qeverisë. Kjo nënkupton që, në njërën anë, vendosja në lidhje me numrin e anëtarëve të qeverisë të jetë autorizim i qeverisë si kolektiv vendimmarrës dhe, në anën tjetër, që kompetenca mbi numrin e anëtarëve të qeverisë, në kuptim të nenit 96.2 të KKos, nuk mund t’i merret dhe/apo të përcaktohet me anë të një ligji të Kuvendit, meqë kjo do të konsiderohej ndërhyrje në fushën ekskluzive të fushëveprimit të qeverisë të përcaktuar me KKos. Në fund, **tre**, autorizimi për të përcaktuar numrin e anëtarëve të qeverisë nënkupton njëkohësisht edhe autorizimin e qeverisë për të themeluar ministritë përkatëse, shefat e të cilëve bëhen në mënyrë automatike edhe anëtar qeverie. Kjo kompetencë, prandaj, sa i përket themelimit të ministrive me anë të aktit të brendshëm nuk mund të pengohet apo zvogëlohet me anë të një akti tjetër të Kuvendit.

Neni 96.3 i **KKos** përcakton përbërjen shumëetnike të qeverisë, dhe garanton ulësen e ministrit për përfaqësuesit e komunitetit serb. Neni 96.3 vendos që në qeveri duhet të ketë së paku një ministër nga komuniteti serb dhe një ministër nga ndonjë komunitet tjetër joshumicë në Kosovë. Megjithatë, neni në fjalë gjithashtu përcakton që nëse në qeveri ka më shumë se 12 ministra, qeveria duhet të ketë edhe një ministër të tretë nga komunitetet joshumicë. Rezervimi i ulëses për të paktën dy ministra nga komunitetet joshumicë është garancion i përfaqësimit të komuniteteve joshumicë në kompozicionin e qeverisë. Duhet thënë që, në kuadër të nenit 96.3, rezervimi i ulëses për të paktën dy ministra nga komunitetet joshumicë nuk e përjashton mundësinë që qeveria të ketë më shumë se dy të tillë. Por, sipas detyrimit nga ky nen, të paktën dy ministra nga komunitetet joshumicë në Kosovë duhet gjithnjë të jenë pjesë e qeverisë. Përfaqësimi i rezervuar i komuniteteve joshumicë në qeveri përbën të ashtuquajturin parim të ”qeverisë së gjerë” në kuptim të shumë etnicitetit dhe paraqet kushtin themelor të **demokracisë konsociacionale**. Ky model i strukturës së qeverisë mundëson që karakteri multietnik i shtetit të gjejë shprehje të garantuar jo thjeshtë për shkak të përfaqësimit të

rezervuar në përbërjen e qeverisë, por edhe për shkak që ministrat që burojnë nga ky nen përfaqësojnë zërin e komuniteteve të tyre në procesin e politikëbërjes në qeveri.

Neni 96.4 i **KKos** përcakton gjithashtu që së paku dy zëvendësministra nga komuniteti serb i Kosovës dhe dy zëvendësministra nga komunitetet tjera joshumicë në Kosovë do të ketë në përbërjen e qeverisë. Nëse në qeveri ka më shumë se 12 ministra, qeveria do të ketë edhe dy zëvendësministra shtesë, një nga komuniteti serb dhe një nga komunitetet tjera joshumicë në Kosovë. Ky nen prandaj mundëson që përveç rezervimit të ulëseve në nivel ministror, komunitetet joshumicë të kenë të garantuara edhe vendet në nivel të zëvendësministrave.

Neni 96.5 i **KKos** përcakton mënyrën e zgjedhjes së ministrave dhe zëvendësministrave nga komunitetet joshumicë në qeverinë e shtetit, dhe vendos mbi procedurën e emërimit të tyre. Ky nen përcakton që emërimi i ministrave dhe zëvendësministrave nga komunitetet joshumicë, sipas nenit 96.4, bëhet pas konsultimit me partitë, koalicionet ose grupet që përfaqësojnë komunitet që nuk janë shumicë në Kosovë. Nëse caktohen kandidatë jashtë strukturës së deputetëve të Kuvendit të Kosovës, për emërimin e tyre kërkohet votimi nga shumica e deputetëve të Kuvendit që u përkasin partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin në fjalë. Shikuar në aspektin juridik, termi ”konsultim” i shfrytëzuar në këtë dispozitë i referohet një procedure ku partia/koalicioni që përfaqëson komunitetin në fjalë në Kuvendin e Kosovës jep kandidaturën e saj në përbërjen e qeverisë që ndërton një i caktuar për kryeministër. Marrja e detyrueshme e kandidatit të propozuar nga partia/koalicioni që përfaqëson komunitetin joshumicë përkatës është e detyrueshme në kuptim të nenit 96.5, përndryshe, në të kundërtën, do të konsiderohet që nuk është përmbushur detyrimi për një konsultim të plotë me partinë/koalicionin sipas këtij neni. Kjo do të thotë se kjo dispozitë kushtetuese imponon një lloj koalicioni parlamentar, qoftë edhe implicit, në mes të partisë/koalicionit që pretendon të formoj qeverinë dhe deputetëve nga komunitetet joshumicë, meqë marrja e kandidatit të tyre në përbërjen e qeverisë është detyrim sipas nenit në fjalë. Ky lloj i koalicionit, qoftë edhe implicit, rezulton në një koalicion parlamentar shumetnik, që është e vetmja rrugë nga mund të zbatohet dispozita që buron nga ky nen. Në rastin kur ministri/zëvendësministri caktohet jashtë përbërjes së parlamentit, atëherë neni 96.5 e bën të detyrueshme që kandidati të votohet nga shumica e deputetëve që i përkasin komunitetit në fjalë në Kuvend. Kështu, ta zëmë, nëse kandidati që zë ulësen e rezervuar në qeveri të ministrit që duhet të vije nga komuniteti serb caktohet jashtë përbërjes së Kuvendit, atëherë shumica e deputetëve serbë të Kuvendin e Kosovës duhet që ta pranojnë një përcaktim të tillë të kryeministrit përmes votimit, në të kundërtën, kandidatura e caktuar nga kryeministri nuk kalon.

Neni 96.6 i **KKos** përcakton që kryeministri, zëvendëskryeministrat, dhe ministrat e qeverisë mund të zgjidhen nga deputetë të Kuvendit të Kosovës ose nga persona të kualifikuar që nuk janë deputetë të Kuvendit. Ky nen e lë mundësinë që kryeministri, ministrat dhe zëvendëskryeministrat e qeverisë të jenë persona që nuk bëjnë pjesë në përbërjen e parlamentit, dhe që nuk janë pjesë e listës së fituesve të mandateve parlamentare. Duhet thënë këtu që ky nen nuk e rregullon faktin nëse është e pajtueshme që kryeministri, ministrat, zëvendëskryeministri dhe zëvendësministrat të jenë njëkohësisht edhe anëtarë të parlamentit. Një gjë e tillë është e përcaktuar gjetiu në KKos, përkatësisht në nenin 72 të saj, ku rregullohet papajtueshmëria e postit të deputetit me çfarëdo posti tjetër ekzekutiv në administratën publike ose në ndonjë ndërmarrje në pronësi publike. Termi ”persona të kualifikuar” sipas nenit 96.6, ndërkaq, i referohet personave të aftë mendërisht, fizikisht dhe të moshës madhore, pavarësisht përgatitjes shkollore dhe profesionale, për të ushtruar detyrën e kryeministrit, zëvendëskryeministrit dhe ministrave. Ky nen përcakton që çështja e papajtueshmërisë së anëtarëve të qeverisë lidhur me funksionet e tyre rregullohet me ligj. Prandaj, ky nen e autorizon Kuvendin që ta zgjidhë këtë çështje me anë të nxjerrjes së ligjit përkatës.

15.5. Përgjegjësia

Neni 97 i **KKos** përcakton përgjegjësinë politike të qeverisë përballë Kuvendit, si dhe mënyrën e kërkimit të përgjegjësisë. Natyra e relacionit mbi të cilin ndërtohet përgjegjësia në mes dyve përbën instrumentin më të rëndësishëm ku edhe ndërtohet nyja parlamentare e demokracisë së shtetit.[200]
Neni 97.1 përcakton që qeveria për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Kosovës. Kjo është dispozita kushtetuese që e detyron qeverinë që të jetë politikisht përgjegjëse përballë Kuvendit për veprimtarinë e saj. Në anën tjetër, është kjo dispozitë që sendërton funksionin mbikëqyrës të Kuvendit përballë qeverisë, dhe në përgjithësi degës së ekzekutivit.[201] Shikuar më thellësisht, përgjegjësia politike që ka qeveria ndaj Kuvendit, përbëhet nga këto karakteristika juridike: një, që qeveria është e detyruar të bart përgjegjësi përpara Kuvendit për mënyrën dhe dinamikën e ushtrimit të funksionit të saj kushtetues; dy, që Kuvendi ka autorizimin e pakufizuar që t'i kërkoj përgjegjësi politike qeverisë në lidhje me detyrimet e saj dhe/apo premtimet e dhëna; tre, që qeveria është e detyruar të mbaj konstant të informuar Kuvendin mbi zhvillimet e rëndësishme në fushën e kompetencave të qeverisë; katër, që Kuvendi ka të drejtë të mbikëqyr çdo veprim të qeverisë në fushat e kompetencave të saj, pas asnjë kufizim kohor apo procedural. Dhënia e përgjegjësisë politike të qeverisë përballë Kuvendit natyrshëm kërkon edhe mekanizmin e nevojshëm kushtetues që të garantoj se në rast se qeveria nuk i përgjigjet Kuvendit, dhe/apo nuk është në dinamikën e kërkuar nga Kuvendi, ky i fundit ta shkarkoj atë. Instrumenti i **shkarkimit** të qeverisë, që është mjeti final të cilin e disponon Kuvendi në dënimin e qeverisë në rast të mosshkarkimit të duhur të përgjegjësisë nga kjo e fundit, rregullohet me një nen të veçantë kushtetues, prandaj edhe e diskutojmë në pjesët e mëposhtme. E kemi fjalën këtu për institucion e njohur si "mocioni i mosbesimit" (neni 100 i **KKos**).

Neni 97.2 përcakton që kryeministri, zëvendëskryeministri, dhe ministrat mbajnë bashkëpërgjegjësinë për vendimet që merr qeveria, dhe përgjegjësinë individuale për vendimet që marrin në fushat e përgjegjësisë së tyre. Neni 97.2 duhet interpretuar ngushtë me nenin 94 të **KKos**, meqë kompetencat e kryeministrit përballë qeverisë janë substanca më kryesore e cila përcakton nëse qeveria bartë përgjegjësi kolektive apo individuale në secilin rast. Në kuptim të kësaj dispozite, qeveria i përgjigjet Kuvendit në dy forma: një, si kolektiv i përbërë nga tërë anëtarët e saj, dhe dy, secili anëtar individualisht për veprimtarinë e tij/saj brenda fushave të kompetencave individuale. Sa i përket përgjegjësisë kolektive, natyrshëm, edhe në ndërlidhje me nenin 94, është kryeministri i qeverisë ai që bartë tërë tagrin e ndërtimit të këtij relacioni me Kuvendin, duke qenë përfaqësues i qeverisë dhe udhëheqës i saj. Duhet thënë megjithatë që përgjegjësia kolektive sipas këtij neni është substancialisht e lidhur me funksionin e kryeministrit, dhe praktikisht është kryeministri ai që merret në përgjegjësi, edhe pse kjo normë përcakton një model kolektiv të përgjegjësisë. Në rastin e dytë, Kuvendi ushtron kontroll të përgjegjësisë individuale ndaj secilit anëtar të qeverisë në fushat e kompetencave të tyre individuale. Në kuptim të përgjegjësisë individuale, sërish në ndërlidhje me nenin 94 të **KKos**, është kryeministri që përbën ombrellën e përgjegjësisë së tërë qeverisë,[202] meqë ai përgjigjet individualisht për kompetencën e tij të përfaqësimit, të udhëheqjes së qeverisë dhe të sigurimit që qeveria ushtron kompetencat e saj në mënyrën e përcaktuar me legjislacion dhe në përputhje me politikat publike të përcaktuara nga vet ajo.

---

200 Shumë heret, në literaturë është vënë në dukje se, nga kontrolli i tepërt parlamentar, mund të paraqitet e ashtuquajtura "anarki parlamentare", gjë që përbën rrezikun e një demokracie parlamentare në kuptim të aftësisë së saj funksionuese. Cf. James W. Garner, "Cabinet Government in France". *The American Political Science Review*. Vol. 8 No. 3 (August 1914), fq. 353-374.

201 Cf. me modelin amerikan të përgjegjësisë politike të presidentit si shef i pushtetit ekzekutiv, dhe krahaso përparësitë e secilit sistem, në artikullin e Charles Grove Haines, "Ministerial Responsibility Versus the Separation of Powers". *The American Political Science Review*. Vol. 16 No. 2 (May 1922), fq. 194-210.

202 Cf. më shumë në Eoin O'Malley, "The Power of Prime Ministers: Results of an Expert Survey". *International Political Science Review/Revue internationale de science politique*. Vol. 28 No. 1 (January 2007), fq. 7-27.

Përgjegjësia politike e qeverisë përballë Kuvendit është tregues gjithashtu edhe i legjitimitetit indirekt popullor që ajo duhet të marrë në Kuvend. Meqë qeveria nuk zgjidhet nga ndonjë burim i drejtpërdrejtë popullor, ajo i detyrohet përgjegjësisë ndaj Kuvendit edhe për shkak të supozimit që Kuvendi është përfaqësues i popullit në modelin parlamentar të shtetit të Kosovës. Në këtë aspekt, shkarkimi i përgjegjësisë politike në Kuvend nënkupton edhe legjitimim indirekt popullor të vet veprimtarisë dhe funksionit të qeverisë, mënyrë e cila mundëson që qeveria të qeverisë në mënyrë të supozuar si legjitime. Prandaj, përgjegjësia politike e vendosur me nenin 97.2 që ka qeveria ndaj Kuvendit strukturalisht përbën rrugën ku qeveria supozohet se legjitimon veten e saj.

15.6. Imuniteti dhe vendimmarrja

Neni 98 i **KKos** përcakton imunitetin e anëtarëve të qeverisë. Sipas këtij neni, anëtarët e qeverisë gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi për veprimet dhe vendimet brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si anëtarë të Qeverisë. Çështja e parë që kërkon komentim është se kë mbulon imuniteti i dhënë me nenin 98 të **KKos**? Termi ”anëtarët e qeverisë” duhet interpretuar në përputhje me nenin 92.1, i cili përcakton që anëtarë të qeverisë janë kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat. Që të tre këto pozita politike janë të veshur me imunitetin e dhënë me nenin 98 të **KKos**.

Sa i përket vëllimit të imunitetit të dhënë me nenin 98, duhet thënë që ky është **imunitet i pastër funksional**,[203] dhe e mbronë kryeministrin, zëvendëskryeministrat dhe ministrat vetëm për veprimet dhe vendimet brenda fushëveprimit të tyre ekzekutiv. Termi ”veprim dhe vendim” brenda fushëveprimit të tyre konsiderohet i mbuluar nga imuniteti i nenit 98 nëse plotëson këto kushte: një, që zyrtari në fjalë të ketë marrë një vendim/veprim brenda kompetencës së tij të dhënë me kushtetutë dhe ligj përkatës; dy, që në kryerjen e veprimit/vendimit të tillë, zyrtari përkatës të ketë ushtruar kompetencën e tij në përputhshmëri me ndalimet kushtetuese dhe ligjore, dhe që t’i jetë përmbajtur detyrimeve që e shoqërojnë kompetencën në fjalë; tre, që vendimi/veprimi i zyrtarit përkatës të mos ketë cenuar të drejtat subjektive të personave tjerë;[204] dhe, katër, që vendimi/veprimi i ndërmarrë nga zyrtari përkatës të përfshijë vetëm autoritetin e tij si anëtar qeverie dhe jo ndonjë kompetencë që mund ta ketë fituar jashtë këtij funksioni.

Është me rëndësi të thuhet se termi ”veprim” i dhënë në nenin 98 i referohet jo thjeshtë veprimeve aktive të zyrtarëve përkatës, por edhe veprimeve pasive të tyre, apo heqjes dorë të tyre nga ushtrimi i një veprimi si funksion i kompetencës së tyre diskrecionale. Prandaj, kjo përfshin si veprimet ashtu edhe mosveprimet që hyjnë në kuadër të kompetencave përkatëse të zyrtarit të caktuar.[205]

Neni 98, në anën tjetër, i mbronë anëtarët e qeverisë nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi brenda funksionit të tyre. Termi ”ndjekja penale”, si e tillë, përfshinë procesin kur hetimi merr autorizim prokurorial, dhe kur zyrtari fillon të hetohet dhe të procedohet penalisht nga ana e prokurorit publik. Termi ”padi civile” i referohet padisë për dëmshpërblimin material apo jomaterial që një subjekt me interes të drejtpërdrejtë juridik mund ta procedojë në gjykatë kundër një anëtari

[203] Që shkon në kundërshtim të plotë me llojin e **imunitetit sovran**. Cf. Chemerinsky, Erwin (2001) ‘Against Sovereign Immunity’. *Stanford Law Review. Symposium: Shifting the Balance of Power? The Supreme Court, Federalism, and State Sovereign Immunity* Vol. 53 No 5 (May 2001), fq. 1201-1224. Me **imunitet sovran** nënkuptohet ai imunitet që mbron bartësit e tij nga çdo ndjekje penale dhe lidhet me cilësinë e bartësit, jo me funksionin e tij. Në vendimin e saj për rastin **KO 98/11**, i cili u diskutua më heret, **GJKRKS** ka mbrojtur **imunitetin e pastër funksional**.

[204] Kjo për shkak që konsiderohet se ka një lidhje strukturale mes gjerësisë së imunitetit të zyrtarëve të lartë dhe hapësirës për shkeljen e të drejtave të njeriut. Cf. më shumë për këtë aspekt në Rosanne van Alebeek, “Immunity and Human Rights? A Bifurcated Approach”. *Proceedings of the Annual Meeting (American Society of International Law* Vol. 104 (March 24-27, 2010), fq. 67-72.

[205] Kjo supozon që personi përkatës është i mbrojtur për veprimet e tilla edhe pas lëshimit të pozitës përkatëse. Shih, Një argument mbi dhënien e imunitetit ish zyrtarëve të lartë shtetëror,në Peter Evan Bass, “Ex-Head of State Immunity: A Proposed Statutory Tool of Foreign Policy”. *The Yale Law Journal.* Vol. 97 No. 2 (December 1987), fq. 299-319.

të qeverisë. Termi ”shkarkim” i referohet shkarkimit të anëtarit të qeverisë jashtë logjikës së përgjegjësisë politike, meqë anëtari i qeverisë nuk bartë imunitet nga shkarkimi në parlament, përderisa ky lloj imuniteti nuk e mbronë ministrin/zëvendëskryeministrin nga kompetenca e kryeministrit për ta ndërruar atë për shkak të veprimeve/vendimeve të tij brenda kompetencave të tij kushtetuese dhe ligjore.

Neni 99 i **KKos** përcakton që mënyra e punës dhe procedurat e vendimmarrjes në qeveri rregullohen me ligj dhe rregullore. Për këtë arsye është lehtësisht e kuptueshme që mënyrën e organizimit të vendimmarrjes së qeverisë e rregullon Kuvendi përmes një ligji, ndërsa e plotëson vet qeveria përmes një rregulloreje të punës së saj. Mundësia që Kuvendi ta rregullojë mënyrën e punës dhe të vendimmarrjes së qeverisë përmes një ligji është garancion që standardet e transparencës, rregullsisë procedurale dhe të efiçencës të vendosen si detyrim mbi qeverinë përmes një ligji të cilit ajo i obligohet. Ky ligj, megjithatë, nuk ekziston akoma në kohën e shkruarjes së këtyre rreshtave (30 janar 2023).

15.7. Mosbesimi dhe votëbesimi

Neni 100 i **KKos** përcakton procedurën e vendosjes së përgjegjësisë politike të Kuvendit mbi qeverinë përmes **mocionit të votëbesimit**.[206] Ky nen, gjithashtu, përcakton edhe palët e autorizuara që mund të iniciojnë mocionet e votëbesimit mbi qeverinë, si dhe përcakton garancionet procedurale që i veshën qeverisë në këtë kuptim.

Neni 100.1 përcakton që **mocioni i mosbesimit** ndaj qeverisë mund të ngrihet me propozimin e një të tretës së të gjithë deputetëve. Praktikisht, një pakicë parlamentare prej 1/3 së të gjithë deputetëve, dyzetë (40) deputetë, ka autorizim kushtetues që të procedojë në Kuvend një mocion mosbesimi ndaj qeverisë. Dhënia e mundësisë një pakice të tillë të deputetëve krijon një ambient relativisht vibrant politik ku deputetët e opozitës të mund të sfidojnë përkrahjen parlamentare të qeverisë,[207] dhe eventualisht të tentojnë rrëzimin e saj përmes kalimit të mocionit të mosbesimit në seancë plenare në Kuvend.[208]

Neni 100.2 përcakton që palë tjetër e autorizuar për të ngritur çështjen me efekt të njëjtë, por me emërtim tjetër: **votëbesimin e qeverisë** mund ta kërkoj kryeministri, pra vetë shefi ekzekutivit kosovar mund të procedojë mocionin e votëbesimit ndaj qeverisë së tij në kuvend.[209] Dhënia e këtij autorizimi për kryeministrin lidhet me dhënien e mundësisë këtij të fundit që të testojë ose të argumentojë mbështetjen parlamentare të qeverisë së tij, dhe/apo që të rrëzojë qëllimisht qeverinë e tij në rastet kur kjo paraqitet si opsion politik i tij. Dhënia e mundësisë së vet kryeministrit për të proceduar një **mocion votëbesimi** ndaj qeverisë së tij gjithashtu lë mundësinë që kryeministri të provojë përballë opozitës parlamentare mbështetjen nga shumica e deputetëve, apo thjeshtë të testoj numrin e ulëseve parlamentare që e mbështesin qeverinë e tij.

---

206 Krahaso këtë me sistemin kushtetues ku pushtetet janë të ndara të mënyrë rigjide, në Charles Grove Haines, “Ministerial Responsibility Versus the Separation of Powers”, fq. 194-210.

207 Cf. Daniel Diermeier, Hülya Eraslan and Antonio Merlo, “A Structural Model of Government Formation”, fq. 27-70.

208 Në rastin kanadez, kishte lindur problem në interpretimin nëse mocioni i votëbesimit të qeverisë nënkuptonte realisht ”votëbesimin” e qeverisë. Ky rast lë nënkuptimin që duhet pasur kujdes në konstruktimin e **mocionit të mosbesimit**, dhe në qartësinë e tij. Shih rastin kanadez në Andrew Heard, “Just What Is a Vote of Confidence? The Curious Case of May 10, 2005”. *Canadian Journal of Political Science/Revue canadienne de science politique*. Vol. 40 (2) (June 2007), fq. 395-416.

209 Si shembull krahasues, **Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë** ka vendosur që kryeministri është i obliguar, sipas Kushtetutës, të ofrojë dorëheqje në rast se Kuvendi Bullgarisë kalon mocion mosbesimi apo kur qeveria dështon të marre votat e mjaftueshme në rast të kërkimit të votëbesimit. Përveç këtyre dy rasteve të cilat janë të parapara në mënyre eksplicite në Kushtetutë, kryeministri nuk është i obliguar të dorëzojë dorëheqjen e qeverisë. Një obligim i tillë nuk kërkohet me Kushtetutë nëse Kuvendi hedh poshtë propozimet e bëra nga kryeministri, përfshirë nismat legjislative. Prandaj, kryeministri nuk është i obliguar të ofrojë dorëheqjen e qeverisë kur Kuvendi refuzon propozimin për themelimin e ministrive të reja apo ndryshimeve në qeveri. Cf. **Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë** Nr. 4/94 i datës 21.6.1994).

Neni 100.3 përcakton që **mocioni i mosbesimit** vihet në rend dite në Kuvend jo më vonë se pesë (5) ditë nga dita e parashtrimit të tij, por as më shpejtë se dy (2) dy ditë nga dita e parashtrimit të tij. Vënia e kufirit kohor prej pesë (5) ditësh për të votuar mocionin e mosbesimit të qeverisë në Kuvend është një lloj garantuesi që qeveria të shkojë në procedurën e kontrollit parlamentar apo edhe të rrëzimit, pa humbur kohë.

Neni 100.4 vendosë rregullin që **mocioni i mosbesimit** ndaj qeverisë konsiderohet i pranuar nëse për të kanë votuar shumica e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, dhe rrjedhimisht konsiderohet që qeveria është shkarkuar nga Kuvendi. Shumica e të gjithë deputetëve të Kuvendit përbën formulën e njëjtë të votimit që shfrytëzohet edhe në rastin e zgjedhjes së qeverisë, e që është gjashtëdhjetë e një (61) vota deputetësh. Me kalimin e mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë, qeveria humb të gjithë autoritetin kushtetues për të kryer kompetencat e saj, dhe **ipso iure** kalohet në procesin e ri të emërimit të qeverisë, përmes propozimit të një kandidati nga ana e Presidentit të Republikës, sipas procedurës së shpjeguar më sipër. Paragrafi në vijim i nenit të njëjtë, neni 100.5, thotë që nëse mocioni i propozuar i mosbesimit ndaj qeverisë nuk kalon, atëherë një mocion tjetër mosbesimi ndaj qeverisë nuk mund të ngrihet gjatë nëntëdhjetë (90) ditëve të ardhshme prej momentit të moskalimit të mocionit të fundit. Kjo përbën një garancion kualitativ që e mbron qeverinë për një periudhë kohore prej 90 ditësh, si një mënyrë që qeveria të mos lëkundet nga kërkesat e shpeshta të opozitës për mosbesim të qeverisë.

Neni 100.6 përcakton që nëse mocioni i mosbesimit votohet për qeverinë në tërësi, qeveria konsiderohet në dorëheqje. Ky nen, prandaj, përcakton pasojën juridike të kalimit të mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë në Kuvend. Në anën tjetër, ky nen qëllimshëm i referohet konceptit ”mocion i mosbesimit për qeverinë në tërësi”. Kjo lë nënkuptimin juridik që një mocion mosbesimi nuk mund të ngrihet edhe ndaj një anëtari individual të qeverisë, p.sh. një ministri apo zëvendëskryeministri. Në mënyrë të njëjtë, **mutatis mutandis**, mocioni individual mosbesimi nuk mund të ngrihet as ndaj kryeministrit si i vetëm: në nënkuptim të nenit 100.6, Kuvendi mund të kaloj një mocion mosbesimi kolektiv ndaj qeverisë si tërësi.

15.8. Shërbimi civil

Neni 101 i KKos përcakton rregullat bazike të shërbimit civil të shtetit. Siç është argumentuar më sipër, pushteti ekzekutiv ka një ndarje vertikale në mes të **nivelit politik**, që janë të zgjedhurit politik të këtij pushteti (kryeministri, ministrat, etj.), dhe **nivelit profesional e civil**, që është shërbimi civil i shtetit. Shërbimi civil përbën një mekanizëm profesional, neutral ndaj politikës, civil dhe meritor, i përhershëm, që është i varur institucionalisht për qeverinë, dhe i cili ushtron në mënyrë profesionale dhe të përhershme funksionin e zbatimit administrativ të detyrave administrative të qeverisë. Shërbimi civil, që përbën komponentin human të administratës shtetërore, garantohet me nenin 101, ku ngërthehen parimet që i ruajnë atij neutralitetin, karakterin civil, profesional dhe meritor.

Neni 101.1 përcakton që përbërja e shërbimit civil të Kosovës duhet të pasqyroj shumë etnicitetin e popullit të Kosovës, duke marrë për bazë parimet e barazisë gjinore dhe standardet e tjera të njohura ndërkombëtarisht. Në kuptim të këtij neni, këtu vendoset garancioni që komunitetet joshumicë në Kosovë duhet të kenë të drejtë të pjesëmarrjes në shërbimin civil në bazë të kuotave proporcionale, sipas pozitës së secilit komunitet në tërësinë e popullit, dhe që kjo do të garantojë që pjesëmarrja shumetnike në shërbimin civil të rezultojë me zbatimin praktik të multietnicitetit në strukturën e administratës shtetërore të Kosovës.

Neni 101.2 përcakton që një **Këshill i Pavarur Mbikëqyrës** (KPM) për shërbimin civil do të sigurojë respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil të Kosovës, si dhe që

ky i fundit të pasqyrojë diversitetin e popullit të Kosovës.[210] Në këtë kuptim, neni 101.2 e vendos KPM-në në funksionin e një institucioni të pavarur që duhet të garantoj që standardet e meritës, profesionalizmit, neutralitetit ndaj politikës dhe të karakterit civil të shërbimit civil të gjejnë shprehje në punën/veprimtarinë e shërbimit civil të shtetit. Natyrshëm, në kuptim të këtij neni, qeveria zhvishet nga kompetenca që të kujdeset për ruajtjen e integritetit profesional dhe civil të shërbimit civil ashtu që kjo kompetencë i bartet një institucioni të pavarur që themelohet sipas kësaj dispozite.

Vendimet e **KPM-së** janë përfundimtare dhe, si të tilla, paraqesin titull të vlefshëm ekzekutiv. U mor vesh, vendimet në fjalë mund të kontestohen në procedurë të konfliktit administrativ vetëm sa i përket ligjshmërisë së tyre. Këtë cilësi të titullit ekzekutiv ato e ruajnë sikur flitet për prestime në të holla ashtu dhe në rastet e prestimeve tjera jo monetare. Këtë pozitë e ka mbrojtur **GJKRKS** në rastet e njohura si ”rastet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës” gjatë viteve 2011-2012. Me këtë rast, **GJKRKS** ka theksuar se procedurat para këtij organi gjysmëgjyqësor duhet të respektojnë rregullat mbi gjykimin e drejtë dhe të paanshëm, duke përfshirë këtu edhe procedurën e ekzekutimit të vendimeve të **KPM-së**, gjë e cila ishte mohuar më parë kur bëhej fjalë për prestimet jomonetare.[211]

16. Qeveria e Shqipërisë

Nenet 95-107 të pjesës së tretë të **KShq** flasin për Këshillin e Ministrave, qeverinë shqiptare, të cilin e përbëjnë kryeministri, zëvendëskryeministri dhe ministrat (neni 95.1 i **KShq**). Këshilli i Ministrave ushtron çdo funksion shtetëror, i cili nuk u është dhënë organeve të pushteteve të tjera shtetërore ose të qeverisjes vendore (neni 95.2 i **KShq**). Formulimi i kësaj dispozite është mjaft i rrallë dhe me vend, sepse normon kompetencën reziduale të ekzekutivit të vendit në një kohë kur ekzistojnë proliferim (përhapje) i institucioneve dhe agjencive të pavarura dhe rregullative që ushtrojnë kompetenca që dikur kanë qenë kompetenca klasike të organeve shtetërore. Presidenti i Republikës, në fillim të legjislaturës, si dhe kur vendi i kryeministrit mbetet vakant, emëron kryeministrin me propozim të partisë ose koalicionit të partive, që ka shumicën e vendeve në Kuvend (neni 96.1 i **KShq**). Në qoftëse kryeministri i emëruar nuk miratohet nga Kuvendi, presidenti emëron një kryeministër të ri brenda 10 ditëve (neni 96.2 i **KShq**). Në qoftëse edhe kryeministri i emëruar rishtas nuk miratohet nga Kuvendi, brenda 10 ditëve Kuvendi zgjedhë një kryeministër tjetër. Në këtë rast presidenti emëron kryeministrin e ri (neni 96.3 i **KShq**). Kur Kuvendi nuk arrin ta zgjedhë kryeministrin e ri, Presidenti i Republikës shpërndan Kuvendin (neni 96.4 i **KShq**).

Kryeministri i emëruar sipas nenit 96, nenit 104 ose 105, i paraqet për miratim Kuvendit, brenda 10 ditëve, programin politik të Këshillit të Ministrave së bashku me përbërjen e tij (neni 97 I KShq). Ministri emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të kryeministrit, brenda 7 ditëve (neni 98.1 i **KShq**). Dekreti shqyrtohet brenda 10 ditëve nga Kuvendi (neni 98.2 i **KShq**). Para fillimit të detyrës, kryeministri, zëvendëskryeministri dhe ministrat betohen para Presidentit të Republikës (neni 99 i **KShq**).

---

210 Si shembull krahasues, **Gjykata Kushtetuese e Hungarisë** në vendimin e saj 29/2011 theksoi se shërbyesit civilë nuk mund të shkarkohen nga detyra pa iu ofruar arsyetim i detajuar për një gjë të tillë. Cf. **Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë** Nr. 29/2011 i datës 7.4.2011).

211 Cf. rastet si vijon: *Aktgjykim në Rastin Nr. KI 47/12. Parashtruesi: Islam Thaçi. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme Rev. Nr. 188/2009, të 7 dhjetorit 2011*. Datë: 16 korrik 2012 (Nr.ref.: AGJ 278/12); *Aktgjykim në Rastin Nr. KI 55/11. Parashtruesi: Fatmir Pireci. Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 518/2010, të 26 nëntorit 2010.* Datë: 16 korrik 2012 (Nr. ref.: RK/277/12); *Aktgjykim në Rastin Nr. KI 129/11. Parashtruesi: Viktor Marku. Vlerësim i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. Dr. 158/2011 të 5 korrikut 2011 dhe vendimit nr. 02/197/2010 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës nga ana e Komunës së Klinës.* Datë: 17 korrik 2012 (Nr. ref.: AGJ/282/12); *Aktgjykim në Rastin Nr. I50/12. Parashtruesi: Agush Llolluni. Vlerësim i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 153/2011, të 4 tetorit 2011, dhe Vendimit Nr. 02 (207) 2010, të 4 tetorit 2010, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës nga Komuna e Junikut*. Datë: 16 korrik 2012 (Nr. ref.: AGJ/279/12); *Aktgjykim në Rastin Nr. KI 108/10. Parashtruesi: Fadil Selmanaj. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ac. nr. 170/2009, të 25 shtatorit 2009.* Datë: 5 dhjetor 2011. Nr. Ref.: AGJ. 163/11); dhe *Aktgjykim në Rastin nr. 104/12. Parashtruesi: Esat Kelmendi. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 647/2011, të 30 nëntorit 2011.* Datë: 20 korrik 2012 (Nr. Ref.: AGJ 285/12).

Këshilli i Ministrave përcakton drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore neni 100.1 i **KShq**) dhe merr vendime me propozim të kryeministrit ose të ministrit përkatës (neni 100.2 i **KShq**). Mbledhjet e tij bëhen të mbyllura (neni 100.3 i **KShq**). Aktet e këshillit janë të vlefshme, kur nënshkruhen nga kryeministri dhe ministri propozues (neni 100.4 i **KShq**) dhe kanë formën e vendimeve dhe udhëzimeve (neni 100.5 i **KShq**). Në një nen të vetëm, **KShq** normon aktet juridike të këshillit që kanë fuqi ligjore: Këshilli i Ministrave, në rast nevoje dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë **akte normative që kanë fuqinë e ligjit**, për marrjen e masave të përkohshme. Këto akte normative i dërgohen menjëherë Kuvendit, i cili mblidhet brenda 5 ditëve nëse nuk është i mbledhur. Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftëse nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve (neni 101 i **KShq**).

Neni në vijim, neni 102 normon kompetencat e kryeministrit të Shqipërisë, i cili ka këto autorizime: a) përfaqëson Këshillin e Ministrave dhe kryeson mbledhjet e tij; b) koncepton dhe paraqet drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe përgjigjet për to; c) siguron zbatimin e legjislacionit dhe të politikave të miratuara nga Këshilli i Ministrave; ç) bashkërendon dhe kontrollon punën e anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe të institucioneve të tjera të administratës qendrore të shtetit; d) kryen detyra të tjera të parashikuara në Kushtetutë e në ligje (neni 102.1 i **KShq**). Kryeministri zgjidhë mosmarrëveshjet ndërmjet ministrave (neni 102.2 i **KShq**) dhe, në zbatim të kompetencave të tij nxjerrë urdhra (neni 102.3 i **KShq**). Ministri, brenda drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, drejton nën përgjegjësinë e tij veprimtarinë që ka në kompetencë. Ministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerrë urdhra dhe udhëzime (neni 102.4 i **KShq**). Ministër mund të caktohet kushdo që ka cilësitë për deputet (neni 103.1 i **KShq**). Ministri nuk mund të ushtroj asnjë veprimtari tjetër shtetërore dhe as të jetë drejtues ose anëtar i organeve të shoqërive fitimprurëse (neni 103.2 i **KShq**). Anëtarët e Këshillit të Ministrave gëzojnë imunitetin e deputetit (neni 103.4 i **KShq**).

Kryeministri ka të drejtë t'i paraqes Kuvendit mocion besimi ndaj Këshillit të Ministrave. Në rast se **mocioni i besimit** votohet nga më pak se gjysma e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, kryeministri, brenda 48 orëve nga votimi i mocionit, i kërkon Presidentit të Republikës shpërndarjen e Kuvendit (neni 104.1 **i KShq**). Presidenti shpërndan Kuvendin brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës (neni 104.2 i **KShq**). Kërkesa për **mocion besimi** nuk mund të paraqitet gjatë periudhës së shqyrtimit të **mocionit të mosbesimit**, sipas nenit 105 (neni 104.3 i **KShq**). Votimi i mocionit nuk mund të bëhet pa kaluar tri ditë nga paraqitja e tij (neni 104.4 i **KShq**). Një e pesta e deputetëve ka të drejtë të paraqes për votim në Kuvend një **mocion mosbesimi** ndaj kryeministrit në detyrë, duke propozuar një Kryeministër të ri (neni 105.1 i **KShq**). Kuvendi mund të votojë një mocion mosbesimi ndaj kryeministrit vetëm duke zgjedhur me votat e më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij një kryeministër të ri (neni 105.2 i **KShq**). Presidenti i Republikës dekreton shkarkimin e Kryeministrit në detyrë dhe emërimin e kryeministrit të zgjedhur jo më vonë se 10 ditë nga votimi i mocionit në Kuvend (neni 105.3 i **KShq**). Kryeministri dhe ministrat janë të detyruar të qëndrojnë në detyrë deri në formimin e Këshillit të Ministrave pasardhës (neni 106 i **KShq**).

Nëpunësit publikë zbatojnë ligjin dhe janë në shërbim të popullit (neni 107.1 i **KShq**). Nëpunësit në administratën publike caktohen me konkurs, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji (neni 107.2 i **KShq**). Garancitë e qëndrimit në detyrë dhe trajtimi ligjor i nëpunësve publikë rregullohen me ligj (neni 107.3 i **KShq**). Me këto dispozita për shërbimin civil, njëjtë si në Kosovë, mbyllet kapitulli për ekzekutivin e vendit.

17. Qeveria e Maqedonisë së Veriut

Nenet 88-97 të kapitullit të tretë të pjesës së tretë të **KMVe** normojnë pozitën kushtetuese të ekzekutivit të këtij vendi. Qeveria është bartëse e pushtetit ekzekutiv (neni 88.1 i **KMVe**). Të drejtat dhe detyrat e veta Qeveria i ushtron në bazë dhe në kuadër të **KMVe** dhe ligjeve (neni 88.2 i **KMVe**). Qeverinë e përbëjnë kryeministri dhe ministrat (neni 89.1 i **KMVe**), të cilët nuk mund të jenë deputetë në Kuvend (neni 89.2 i **KMVe**). Ata gëzojnë imunitet, për të cilin vendos qeveria (neni 89.3 i **KMVe**). Neni 89.4 i **KMVe** ka

një dispozitë interesante, ku përcakton se kryeministri dhe ministrat nuk i nënshtrohen detyrimit në forcat e armatosura. Papajtueshmëria e funksioneve normohet në nenin 89.5 të **KMVe** që thotë se funksioni i kryetar i qeverisë dhe ministër nuk pajtohet me ushtrimin e funksioneve ose profesioneve të tjera publike. Në paragrafin e fundit të këtij neni përcaktohet që organizimi dhe mënyra e punës së Qeverisë rregullohet me ligj. Me amendamentin XXIII në **KMV**e, datë 7 dhjetor 2005, është zëvendësuar paragrafi 3 i nenit 89, ashtu që tani përcaktohet si vijon: Kryeministri gëzon imunitet, për të cilin vendos Kuvendi.

Presidenti i Republikës e ka për detyrë që në afat prej dhjetë ditëve, nga dita e konstituimit të Kuvendit, mandatin për formimin e qeverisë t'ia besojë kandidatit të partisë, përkatësisht partive që kanë shumicë në Kuvend (neni 90.1 i **KMVe**). Mandatari, në afat prej 20 ditëve, nga dita e besimit të mandatit, Kuvendit ia paraqet programin dhe i propozon përbërjen e Qeverisë (neni 90.2 i **KMVe**). Qeverinë, me propozim të mandatarit dhe në bazë të programit, e zgjedhë Kuvendi me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Kompetencat e Qeverisë përcaktohen me nenin 91 të KMVe dhe janë për sa vijon: cakton politikën e zbatimit të ligjeve dhe rregullave të tjera të Kuvendit dhe mbanë përgjegjësi për zbatimin e tyre; propozon ligje, buxhetin e republikës dhe rregulla të tjera të cilat i nxjerrë Kuvendi; propozon planin hapësinor të republikës; propozon vendime për rezervat e republikës dhe kujdeset për realizmin e tyre; miraton urdhëresa dhe rregulla të tjera për zbatimin e ligjeve; cakton parimet për organizimin e brendshëm dhe për punën e ministrive dhe organeve të tjera të administratës, orienton dhe bën mbikëqyrje mbi punën e tyre; jep mendime për propozimligjet dhe rregullat e tjera të cilat Kuvendit ia paraqesin propozuesit e tjerë të autorizuar; vendos për njohjen e shteteve dhe qeverive; vë marrëdhënie diplomatike dhe konsullore me shtetet e tjera; merr vendime për hapjen e përfaqësive diplomatike-konsullore jashtë vendit; propozon emërimin e ambasadorëve dhe përfaqësuesve të Republikës së Maqedonisë jashtë vendit dhe emëron shefat e përfaqësive konsullore; propozon prokurorë publik; bën emërime dhe shkarkime të bartësve të funksioneve publike dhe funksioneve të tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj, dhe kryen punë të tjera të përcaktuara me **KMVe** dhe me ligj.
Qeveria dhe çdo anëtar i saj, për punën e vet përgjigjen para Kuvendit (neni 92.1 i **KMVe**), i cili mund t'ia votojë mosbesimin asaj (neni 92.2 **KMVe**). **Mocionin e besimit**, qeverisë mund t'i parashtrojnë së paku 20 deputetë (neni 92.3 i **KMVe**), kurse votimi për besimin e qeverisë bëhet pas kalimit të tri ditëve nga parashtrimi i mocionit për besim (neni 92.4 i **KMVe**). Mocion i serishëm për besim të qeverisë nuk mund të parashtrohet para kalimit të 90 ditëve prej votimit të fundit të mocionit për besim, përveç nëse mocionin e besimit e parashtrojnë shumica nga numri i përgjithshëm i deputetëve (neni 92.5 i **KMVe**). Vendimi për **votimin e mosbesimit** të qeverisë merret me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Nëse qeverisë i është **votuar mosbesimi**, qeveria e ka për detyrë të paraqesë dorëheqje (neni 92.6 i **KMVe**)

Qeveria ka të drejtë të parashtrojë **mocion besimi** para Kuvendit (neni 93.1 i KMVe). Qeveria ka të drejtë të paraqes dorëheqje (neni 93.2 i KMVe). Dorëheqja e kryetarit të qeverisë, vdekja ose pamundësia e përhershme e tij që ta ushtrojë funksionin, rezulton me dorëheqjen e qeverisë (neni 93.3 i KMVe). Qeverisë i pushon mandati kur shpërndahet Kuvendi (neni 93.4 i KMVe). Qeveria, së cilës i është votuar **mosbesimi**, e cila ka dhënë dorëheqje ose së cilës i pushon mandati për shkak të shpërndarjes së Kuvendit, mbetet në detyrë deri në zgjedhjen e qeverisë së re (neni 93.5 i KMVe).

Anëtari i qeverisë ka të drejtë të paraqes **dorëheqje** (neni 94.1 i **KMVe**). Kryetari i qeverisë mund të propozojë shkarkimin e anëtarit të qeverisë (neni 94.2 i **KMVe**). Për propozimin për shkarkimin e anëtarit të qeverisë vendos Kuvendi në seancën e parë të ardhshme (neni 94.3 i **KMVe**). Nëqoftëse kryetari i qeverisë propozon shkarkimin e më shumë se një të tretës së anëtarëve të qeverisë të përbërjes fillestare, Kuvendi vendos sikur për zgjedhjen e qeverisë së re (neni 94.4 i **KMVe**). Këto dispozita, sikundër shihet, fuqizojnë parlamentin e këtij vendi fqinjë dhe, nuk do mend, përfaqësojnë relikt të sistemit të dikurshëm të kuvendeve që ka ekzistuar në ish-Jugosllavi. Nuk arsyetohet me rregullat e parlamentarizimit dhe të

ndarjes e balancimit të pushteteve kjo ingerencë kaq e gjerë e Kuvendit të Maqedonisë së Veriut për shkarkim dhe ngarkim të ministrave dhe kontrollit të legjitimitetit të krejt ekzekutivit, në rastet kur vjen deri të propozimi për shkarkim të më shumë se një të tretës së ekzekutivit të vendit. Njëjtë, siç e pamë, vlen edhe për **KShq**, e cila i jep kompetenca të mëdha shefit të shtetit në ngarkimin dhe shkarkimin e ministrave shqiptar. Edhe në këtë rast bëhet fjalë për relikte nga sistemi presidencial, përkatësisht nga roli i fuqishëm që në shtetin shqiptar ka luajtur shefi i shtetit në të kaluarën, përfshirë edhe kohën pas rënies së komunizmit.

Administratën shtetërore e përbëjnë ministritë dhe organet e tjera të administratës dhe organizatat e përcaktuara me ligj (neni 95.1 i **KShq**). Ndalohet organizimi dhe veprimi politik në organet e administratës shtetërore (neni 95.2 i **KShq**). Organizimi dhe puna e organeve të administratës shtetërore rregullohet me ligj i cili nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve (neni 95.3 i **KShq**). Organet e administratës shtetërore punët nga kompetenca e tyre i ushtrojnë në mënyrë të pavarur në bazë dhe në kuadër të kushtetutës dhe ligjeve dhe për punën e tyre i përgjigjen qeverisë (neni 96 i **KMVe**). Organet e administratës shtetërore në fushën e mbrojtjes dhe policisë i udhëheqin persona civilë, të cilët drejtpërsëdrejti para zgjedhjes në ato funksione kanë qenë civilë së paku tre vjet (neni **97**).

18. Qeveria e Malit të Zi

Kapitulli i tretë i pjesës së tretë të **KMZi** që rregullon organizimin e pushtetit i dedikohet ekzekutivit të këtij vendi (nenet 100-112 i **KMZi**) dhe fillon me kompetencat kushtetuese të këtij organi, jo me definimin e fizionomisë së tij. Qeveria e **Malit të Zi** kryen këto punë: 1. Udhëheq me politikën e brendshme dhe të jashtme të Malit të Zi; 2. Ekzekuton ligjet, dispozitat tjera dhe aktet e përgjithshme; 3. Nxjerr rregullore, vendime dhe akte të tjera për ekzekutimin e ligjeve; 4. Lidh marrëveshje ndërkombëtare; 5. Propozon planin e zhvillimit dhe planin hapësinor të Malit të Zi; 6. Propozon buxhetin dhe llogarinë përfundimtare; 7. Propozon strategjinë e sigurisë kombëtare dhe të mbrojtjes; 8. Vendos për njohjen e shteteve dhe themelimin e marrëdhënieve diplomatike dhe konsullore me shtetet tjera; 9. Propozon ambasadorët dhe shefat e misioneve të tjera të Malit të Zi në botën e jashtme; 10. Kryen edhe punë ë tjera të përcaktuara me **KMZi** dhe ligj (neni 100 i **KMZi**). Neni në vijim rregullon autorizimin e ekzekutivit të këtij vendi për nxjerrjen e dekreteve me fuqi ligjore. Gjatë kohës së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme, Qeveria mund të nxjerrë dekrete me fuqi ligjore, nëse Kuvendi nuk ka mundësi të mblidhet (neni 101.1 i **KMZi**). Qeveria ka për detyrë që dekretet me fuqi ligjore t'i paraqes në Kuvend për miratim (ratifikim) në momentin kur Kuvendi ka mundësi të mblidhet (neni 101.2 i **KMZi**).

Qeveria përbëhet nga kryetari, një ose më shumë zëvendësa dhe ministrat (neni 102.1 i **KMZi**). Kryetari i qeverisë përfaqëson qeverinë dhe udhëheq me punën e saj (neni 102.2 i **KMZi**). Presidenti i Malit të Zi propozon mandatarin për formimin e qeverisë 30 ditë pas konstitutimit të Kuvendit (neni 103.1 i **KMZi**). Mandatari i paraqet Kuvendit programin dhe përbërjen e qeverisë (neni 103.2 i **KMZi**). Mbi programin e mandatarit dhe përbërjen e qeverisë vendoset njëkohësisht (neni 103.3 i **KMZi**). Kryetari i qeverisë dhe anëtarët e saj nuk mund të ushtrojnë detyrën e deputetit dhe asnjë funksion tjetër publik dhe as të ushtrojë ndonjë veprimtari tjetër profesionale (neni 103.4 i **KMZi**).

Qeveria dhe ndonjëri prej anëtarëve të saj mund të japin dorëheqje (neni 104.1 i **KMZi**). Dorëheqja e kryetarit të qeverisë konsiderohet dorëheqje e qeverisë (neni 104.2 i **KMZi**). Kryetari mund t'i propozoj Kuvendit shkarkimin e anëtarit të qeverisë (neni 104.3 i **KMZi**). Qeveria mund të paraqes në Kuvend çështjen e **besimit** të saj (neni 105 i **KMZi**). Neni në vijim, neni 107 i **KMZi** normon çështjen e mosbesimit të ekzekutivit të vendit. Kuvendi mund ta votoj mosbesimin e qeverisë (neni 107.1 i **KMZi**). Propozimin për votim të mosbesimit ndaj qeverisë mund ta paraqesin së paku 27 deputetë (neni 107.2 i **KMZi**). Nëse Qeveria merr besimin, nënshkruesit e propozimit nuk mund të paraqesin propozim të ri për votim të mosbesimit para kalimit të 90 ditëve nga votimi i dështuar mbi mosbesimin (neni 107.3 i **KMZi**).

Interpelancen për shtjellim të çështjeve të caktuara lidhur me punën e qeverisë mund ta paraqesin së paku 27 deputetë (neni 108.1 i **KMZi**). Kërkesa për interpelancë paraqitet me shkrim dhe duhet të jetë e arsyetuar (neni 108.2 i **KMZi**). Qeveria paraqet përgjigjen në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës për interpelancë (neni 108.3 i **KMZi**). Gjithashtu me kërkesë të 27 deputetëve, Kuvendi mund të themeloj këshill anketues me qëllim të mbledhjes së informatave dhe fakteve mbi ngjarjet që kanë të bëjnë me punën e organeve shtetërore (neni 109 i **KMZi**).

Mandati i qeverisë pushon në këto raste: me ndërprerjen e mandatit të Kuvendit, me dorëheqje, kur humbë besimin dhe nëse nuk paraqet buxhetin deri më 31 mars të vitit buxhetor (neni 110.1 i KMZi). Qeveria mandati i së cilës ka pushuar vazhdon deri në zgjedhjen e qeverisë në përbërje të re (neni 110.2 i **KMZi**). Qeveria mandati i së cilës ka pushuar nuk mund ta shpërndaj Kuvendin (neni 110.3 i **KMZi**).

Punët e administratës shtetërore i kryejnë ministritë dhe organet tjera të administratës (neni 111 i **KMZi**). Disa punë të administratës shtetërore me ligj mund të barten në vetëqeverisjen lokale ose në personin tjetër juridik (neni 112.1 i **KMZi**). Disa punë të administratës shtetërore me dispozita të qeverisë mund t'i besohen vetëqeverisjes lokale ose personit tjetër juridik (neni 112.2 i **KMZi**).

19. Qeveria e Serbisë

Kapitulli i tretë i pjesës së tretë të **KSerb** që rregullon marrëdhëniet e pushtetit (nenet 122-135) bën fjalën për qeverinë e Serbisë. Në nenin 122 thuhet se qeveria është bartës i pushtetit ekzekutiv në Republikën e Serbisë. Për qeverinë miratohen një ligj i veçantë (neni 135 i **KSerb**). Ajo ka kompetencat për sa vijon: 1. Përcakton dhe udhëheq me politikën; 2. Ekzekuton ligjet dhe aktet tjera të përgjithshme të Kuvendit të Serbisë; 3. Nxjerrë rregullore dhe akte të tjera të përgjithshme me qëllim të ekzekutimit të ligjeve; 4. I propozon Kuvendit ligjet dhe aktet tjera të përgjithshme dhe jep mendim për të njëjtat kur ato propozohen nga organet tjera; 5. Drejton dhe harmonizon punën e organeve të administratës dhe kryen mbikëqyrje ndaj punës së tyre; 6. Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me KSerb dhe ligj (neni 123 i **KSerb**). Qeveria është përgjegjës para Kuvendit për politikën e Republikës së Serbisë, për ekzekutim të ligjeve dhe akteve të tjera të përgjithshme të Kuvendit dhe për punën e organeve të administratës shtetërore (neni 124 i **KSerb**).

Qeverinë e përbëjnë kryetari i qeverisë, një ose disa nënkryetar dhe ministrat (neni 125.1 i **KSerb**). Kryetari qeverisë udhëheq dhe i jep drejtim punës së qeverisë, kujdeset për veprim të unifikuar politik të qeverisë, harmonizon punën e anëtarëve të Qeverisë dhe përfaqëson qeverinë (neni 125.2 i **KSerb**). Ministrat për punën e tyre dhe për gjendjen nga sfera e veprimtarisë së ministrive përgjigjen para kryetarit të qeverisë, qeverisë dhe Kuvendit (neni 125.3 i **KSerb**). Anëtar i qeverisë nuk mund të jetë deputeti Kuvendit, deputeti në kuvendin e krahinës autonome dhe këshilltarët në kuvendin e njësisë së vetëqeverisjes lokale, as anëtari i këshillit ekzekutiv të krahinës autonome ose organit ekzekutiv të njësisë së vetëqeverisjes lokale (neni 126.1 i **KSerb**). Me ligj rregullohet cilat funksione të tjera, punë ose interesa private bien ndesh me pozitën e anëtarit të qeverisë (neni 126.2 i **KSerb**).

Kandidatin për kryetar të qeverisë e propozon në Kuvend Presidenti i Republikës, pasi të dëgjoj mendimet e përfaqësuesve të listave fituese zgjedhore (neni 127.1 i **KSerb**). Kandidati për kryetar të qeverisë ia paraqet Kuvendit programin qeveritar së bashku me propozimin për përbërjen e ekzekutivit të ri (neni 127.2 i **KSerb**). Kuvendi voton në të njëjtën kohë për programin dhe për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të qeverisë (neni 127.3 i **KSerb**). Qeveria zgjidhet nëse për të kanë votuar shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit (neni 127.4 i **KSerb**). Mandati i qeverisë zgjatë deri në përfundimin e mandatit të Kuvendit që e ka zgjedhur (neni 128.1 i **KSerb**). Mandati fillon të rrjedhë nga dita e dhënies së betimit para Kuvendit (neni 128.2 i **KSerb**), kurse përfundon para kohës për të cilën është zgjedhur me votim të mosbesimit, shpërndarjen e Kuvendit, dorëheqjen e kryetarit të qeverisë dhe në rastet të tjera të përcaktuara me KSerb (neni 128.3 i **KSerb**). Qeveria së cilës i ka mbaruar mandati mund të kryej vetëm punët e domos-

doshme të përcaktuar me ligj, deri në zgjedhjen e qeverisë së re (neni 128.4 i **KSerb**). Qeveria me mandat të mbaruar nuk mund të propozoj shpërndarjen e Kuvendit (neni 128.5 i **KSerb**). Anëtarit të qeverisë i mbaron mandati para kohës për të cilën është zgjedhur me dorëheqje të pranuar, votim të mosbesimit në Kuvend dhe shkarkim nga ana e Kuvendit me propozim kryetarit të qeverisë (neni 128.6 i **KSerb**).

Së paku 50 deputetë të Kuvendit mund të kërkojnë **interpelancë** lidhur me punën e Qeverisë ose ndonjërit prej anëtarëve të saj (neni 129.1 i **KSerb**). Qeveria ka për detyrë të përgjigjet në interpelancë brenda afatit prej 30 ditëve (neni 129.2 i **KSerb**). Kuvendi debaton dhe voton për përgjigjen e qeverisë ose anëtarit të saj lidhur me interpelancën (neni 129.3 i **KSerb**). Me votimin për pranim të përgjigjes Kuvendi vazhdon të punoj sipas rendit të miratuar (neni 129.4 i **KSerb**). Nëse Kuvendi me votim nuk pranon përgjigjen e qeverisë ose anëtarit të saj, atëherë kalohet në votim për mosbesim të qeverisë ose anëtarit të saj, nëse paraprakisht, pas mospranimit të përgjigjes në interpelancë, kryetari i qeverisë, përkatësisht anëtari i saj nuk ka dhënë dorëheqjen (neni 129.5 i **KSerb**). Mbi çështjen që ka qenë objekt interpelance nuk mund të debatohet sërish para kalimit të afatit prej 90 ditëve (neni 129.6 i **KSerb**). Sikundër shihet, ngushtësisht e lidhur me interpelancës, në KSerb është çështja e mosbesimit të Qeverisë, ani pse në nenin 130 në mënyrë specifike rregullohet çështja e mosbesimit të qeverisë ose anëtarit të saj. Votimi për **mosbesim** të qeverisë ose anëtarin e saj mund të kërkohet nga së paku 60 deputetë të Kuvendit (neni 130.1 i **KSerb**). Propozimin për votim mbi mosbesimin e qeverisë ose anëtarit të saj Kuvendi i shqyrton në seancën e parë të radhës, jo më herët se pesë ditë pas paraqitjes së propozimit. Pas debatit e shqyrtimit të propozimit, kalohet në votim për propozimin (neni 130.2 i **KSerb**). Konsiderohet se Kuvendi ka miratuar propozimin për votim të mosbesimit ndaj Qeverisë ose anëtarit të saj nëse për të kanë votuar më shumë së gjysma e krejt deputetëve të Kuvendit (neni 130.3 i **KSerb**). Nëse Kuvendi voton mosbesimin ndaj qeverisë ose anëtarit të saj, Presidenti Republikës ka për detyrë të nis procedurën për zgjedhjen e qeverisë së re. Nëse Kuvendi nuk zgjedh qeverinë e re brenda 30 ditëve nga dita e votimit të mosbesimit, Presidenti i Republikës ka për detyrë të shpërndaj Kuvendin dhe të shpallë zgjedhjet e reja (neni 130.4 i **KSerb**). Nëse Kuvendi voton për mosbesimin e anëtarit të qeverisë, kryetari i qeverisë ka për detyrë që të nis procedurën për zgjedhjen e anëtarit të ri të qeverisë, në pajtim me ligjin (neni 130.5 i **KSerb**). Nëse nuk votohet mosbesimi ndaj qeverisë ose anëtarit të saj, nënshkruesit e propozimit nuk mund të paraqesin një tjetër propozim për votim mbi mosbesimin pa kaluar afati prej 90 ditëve (neni 130.6 i **KSerb**).

Neni tjetër në vijim, neni 131 i KSerb normon institutin e **votëbesimit** të qeverisë. Qeveria mund të kërkoj votim për besimin ndaj saj (neni 131.1 i **KSerb**). Propozimi për votëbesim të qeverisë mund të diskutohet, sipas kërkesës së qeverisë, edhe në mbledhjen e Kuvendit që është në vijim e sipër, mirëpo nëse një kërkesë e tillë nuk ekziston nga ana e qeverisë, atëherë propozimi shqyrtohet në seancën e parë të radhës, jo më herët se pesë ditë pas paraqitjes së propozimit. Pas përfundimit të shqyrtimit, votohet për votëbesimin (neni 131.2 i **KSerb**). Kuvendi ka miratuar propozimin për votëbesim nëse për të kanë votuar më shumë se gjysma e krejt deputetëve (neni 131.3 i i **KSerb**). Nëse Kuvendi nuk voton besimin e qeverisë, asaj i pushon mandati kurse Presidenti Republikës ka për detyrë të nisë procedurën për zgjedhjen e qeverisë së re. Nëse Kuvendi nuk zgjedhë qeverinë e re brenda 30 ditëve nga dita e mosvotimit të besimit, Presidenti Republikës ka për detyrë të shpërndaj Kuvendin dhe të shpallë zgjedhjet e reja parlamentare (neni 131.4 i **KSerb**).

Kryetari i qeverisë mund të paraqes dorëheqjen në Kuvendin e Serbisë (neni 132.1 i **KSerb**). Dorëheqja i dorëzohet kryetarit të Kuvendit dhe për të njëkohësisht njoftohet publiku (neni 132.2 i **KSerb**). Në seancën e parë të radhës, Kuvendi konstaton dorëheqjen e kryetarit të qeverisë (neni 132.3 i **KSerb**). Qeverisë i ndërpritet mandati ditën e konstatimit të dorëheqjes së kryetarit të saj (neni 132.3 i **KSerb**). Kur Kuvendi konstaton dorëheqjen, Presidenti i Republikës ka për detyrë të nis procedurën për zgjedhjen e qeverisë së re. Nëse Kuvendi nuk zgjedhë qeverinë e re brenda 30 ditëve nga dita e konstatimit të dorëheqjes së kryetarit të qeverisë, Presidenti i Republikës ka për detyrë të shpërndaj Kuvendin dhe të shpallë zgjedhjet e reja parlamentare (neni 132.4 i **KSerb**). Anëtari i qeverisë mund të jep dorëheqje, të cilën ia paraqet kryetarit të qeverisë (neni 133.1 i **KSerb**). Kryetari ia paraqet dorëheqjen kryetarit të Kuvendit, kurse Kuvendi në seancën e parë të radhës e konstaton atë (neni 133.2 i **KSerb**). Kryetari qeverisë mund të propozoj shkarkimin

e anëtarit të saj (neni 133.3 i **KSerb**). Kuvendi shqyrton dhe voton për shkarkimin e anëtarit të Qeverisë në seancën e parë të radhës (neni 133.4 i **KSerb**). Vendimi për shkarkimin e anëtarit të qeverisë konsiderohet se ekziston nëse për të kanë votuar shumica e krejt deputetëve (neni 133.5 i **KSerb**). Anëtarit të qeverisë që ka dhënë dorëheqje i ndërpritet mandati ditën e konstatimit të dorëheqjes, kurse anëtarit të qeverisë që është shkarkuar, ditën që është marrë vendimi për shkarkim (neni 133.6 i **KSerb**). Pozita dhe autorizimet e anëtarit të qeverisë që ka dhënë dorëheqje ose që është shkarkuar, deri në ndërprerje të mandatit, rregullohen me ligj (neni 133.7 i **KSerb**). Kryetari qeverisë ka për detyrë që, në momentin e ndërprerjes së mandatit të anëtarit të qeverisë për shkak të dorëheqjes/shkarkimit, në pajtim me ligjin të nisë procedurën për zgjedhjen e anëtarit të ri të qeverisë (neni 133.8 i **KSerb**).

Kryetari i qeverisë dhe anëtarët e saj nuk japin përgjigje për mendimin e shprehur në seancat e Kuvendit ose për votim në seancat e qeverisë (neni 134.1 i **KSerb**). Kryetari i qeverisë ose anëtari i saj gëzojnë imunitet si deputetët e Kuvendit. Mbi imunitetin e tyre vendos qeveria (neni 134.2 i **KSerb**).

20. Gjykatat

20.1. Mbi natyrën e pushtetit gjyqësor

Çdo gjë do të humbej sikur organi ose zyrtari i njëjtë, qoftë nga fisnikëria apo populli, të ushtronte pushtetin ligjvënës, pushtetin e ekzekutimit të ligjeve dhe pushtetin e gjykimit të krimeve ose zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mes personave privatë. Këto fjalë të filozofit francez, **Monteskie,** tingëllojnë sot fuqishëm dhe me domethënie, ashtu siç kanë kumbuar ditën kur janë thënë.[212] Ky përshkrim i parimit të ndarjes së pushtetit, në të vërtetë tregon sa i rëndësishëm është që pushteti gjykimit të jetë i ndarë nga dy pushtetet tjera - pushteti ligjvënës dhe pushteti ekzekutiv. Gjyqësori është dega e tretë e pushtetit, i ndryshëm nga dy të tjerët shkaku i natyrës dhe veprimtarisë së tij.

Gjykatat zbatojnë të drejtën në një rast konkret. Gjykata vepron kur ekziston një kontest apo mosmarrëveshje mes shtetit dhe individit (e drejta penale) apo mes personave privat (e drejta civile). Përmes gjykimit mbrohen vlerat shoqërore, siç janë: e drejta, rendi juridik dhe politik, sundimi ligjit dhe shteti i së drejtës, kushtetutshmëria dhe ligjshmëria, liritë dhe të drejtat njerëzore. Për shkak të këtij detyrimi të mbrojtjes së vlerave në fjalë, gjykata për nga natyra e vet duhet të jetë organ jopolitik, për dallim nga parlamenti, qeveria dhe shefi shtetit. Për të qenë në nivel të detyrës, realizimit të drejtësisë dhe objektivitetit në gjykim, gjykatat duhet të përbëhet nga gjyqtarët që janë të mbrojtur nga pushteti autoriteteve politike. Veçantia e gjyqësorit konsiston në atë se bartësit e këtij funksioni janë gjyqtarë profesionistë, prapa të cilëve qëndron arsimimi i gjatë juridik, jo rrallë vijnë nga një shtresë e caktuar shoqërore (në disa vende me traditë të gjatë të shtresës së aristokracisë), janë konservativë, formalë dhe të ngurtë, karakteristika këto që i dallojnë nga ministrat dhe përfaqësuesit e popullit në parlament.

Roli i gjyqeve në shtet është të vënë epërsinë e të drejtës ndaj pushtetit politik dhe pushtetit tjetër. Në shtetin e sundimit të së drejtës, pushteti duhet të jetë demokratik dhe i kontrolluar, që nënkupton se fuqia dhe pushteti i organeve politike duhet të qëndrojnë brenda kufijve të kushtetutës dhe ligjit. Për këtë kujdesen gjyqet. Fakti se e drejta gjendet mbi pushtetin vërtetohet nga kompetenca e gjyqeve për të konstatuar përgjegjësinë penalo-juridike dhe materialo-juridike të krejt anëtarëve të bashkësisë shtetërore - bartësve të funksioneve publike dhe qytetarëve. Arsyetimi i pushtetit të gjykatave për të konstatuar përgjegjësinë dhe ndëshkuar mund të gjendet në teorinë e **kontratës shoqërore** me të cilën qytetarët janë pajtuar për një gjë të tillë, pra për konstatim të përgjegjësisë dhe shqiptim të sanksioneve ndaj anëtarëve të bashkësisë shtetërore, pa marrë parasysh statusin e tyre në shoqëri. Ky pëlqim është dhënë nga qytetarët për shkak se gjyqet, krahas shqiptimit të sanksioneve, ofrojnë edhe mbrojtjen juridike që është një interes i përgjithshëm shoqëror.

[212] Cf. fusnota 28, **supra** , në këtë pjesë, si dhe teksti që e shoqëron.

Gjykata mbron**ë** interesin e përgjithshëm shoqëror dhe zbaton të drejtën. Sipas një pikëpamjeje, asaj **pozitiviste-juridike**, e rëndësishme për mbrojtjen e sistemit juridik është ekzistimi i ligjeve, pra që të ketë ligje në shoqëri, të cilat kanë harmoni mes veti, si dhe gjyqe që zbatojnë dhe mbrojnë këtë të drejtë pozitive. Sipas kësaj pikëpamie, krejt e dorës së dytë është përmbajtja e atyre ligjeve, pra nuk ka rëndësi se çfarë përmbahet në to. Sipas pikëpamjes së dytë, asaj **liberalo-demokratike**, përveç ligjeve të harmonizuara mes veti dhe gjyqeve që zbatojnë të drejtën, rëndësi të madhe kanë përmbajtjet e ligjeve. Sundimi i së drejtës ekziston vetëm atëherë kur përmbajtja e ligjeve është demokratike, ashtu që garanton lirinë, barazinë dhe trajtimin e barabartë, dinjitetin dhe të drejtat dhe liritë njerëzore. Kjo nënkupton se, në çdo rast, vlerat që mbron**ë** gjykata me vendimet e saj burojnë (rrjedhin) nga një ideologji që përmbajnë kushtetuta dhe ligjet. Pikëpamja e parë është **kuptimi i ngushtë** apo i hollë i sundimit të së drejtës, kurse pikëpamja e dytë përfaqëson **kuptimin e gjerë** apo të trashë të **sundimit të ligjit**.[213] Çdoherë me ligj nënkuptohet jo vetëm ligji në kuptimin tekniko-juridik të aktit që ka fuqi, në parim, më të ulët se kushtetuta dhe vjen menjëherë pas saj, por çdo normë dhe akt juridik që rregullon dhe afekton marrëdhëniet mes subjekteve të së drejtës, në cilin do nivel qoftë.

Gjyqësori është degë e pushtetit, e cila, në mënyrë autoritative, të pavarur dhe sovrane, me fuqinë me të lartë shtetërore, zgjidh**ë** mosmarrëveshjet dhe rastet përmes instrumentit të së drejtës si fenomen shoqëror (tërësi e rregullave juridike). Në shoqëri ekzistojnë pikëpamje dhe qëndrime të ndryshme të njerëzve dhe institucioneve lidhur me atë se çka është e drejtë, drejtësi, drejtshmëri, ndershmëri. Ato mund të definohen nga këndi moralit, filozofisë, shkencës juridike dhe shkencave të tjera. Pushteti gjyqësor, megjithatë, ka status të atillë në shtet që ia garanton të drejtën për të pasur fjalën përfundimtare, përkatësisht për të vendosur se çka është e drejta dhe ligjshmëria, drejtësia dhe e vërteta (u mor vesh, e vërteta gjyqësore) në një mosmarrëveshje apo kontest konkret, për të cilën nxjerr vendim dhe shqipton sanksion.

Duke treguar me vendim se çfarë është e drejta, gjykata interpreton normën juridike në një rast konkret dhe, përmes tij, interpreton krejt sistemin juridik pjesë e të cilit është norma që interpretohet. Interpretimi i gjyqit ka autoritetin e çështjes së gjykuar (**res judicata**), që nënkupton se me vendim të formës së prerë është konstatuar e vërteta gjyqësore dhe se përjashtohen kontestet e mëtejme dhe mosmarrëveshjet lidhur me të njëjtën çështje. Kjo nuk nënkupton, megjithatë, se gjyqet kanë liri të pakufizuar për gjykim. Krejt e kundërta, gjyqësori është i lidhur me kushtetutë e ligj, ai qëndron nën ligj për arsye se vendimet duhet merren bazuar në të. Nganjëherë thuhet se vetë vendimi apo verdikti i gjyqit gjendet i mbërthyer në ligj, gjyqtari vetëm duhet të nxjer**rë** dhe zbatoj ndaj rastit dhe mosmarrëveshjes konkrete. Një kufizim tjetër i gjyqit është se ai vihet në lëvizje dhe gjykon në bazë të kërkesës së palëve, përkatësisht sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Me fjalë të tjera, gjyqet nuk drejtojnë apo administrojnë, **ato nuk udhëheqin shtetin**, por vihen në lëvizje sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Shikuar në aspektin historik, duhet bërë dallimi mes **pushtetit gjyqësor** dhe **veprimtarisë së gjykimit**. Aktiviteti i gjykimit, me të cilin zgjidhet një kontest, është funksioni më i hershëm brenda shtetit, përkatësisht brenda një bashkësie. Pushtetin gjyqësor dhe gjyqet siç i njohim sot, megjithatë, i hasim vetëm në shtetet kushtetuese moderne, të bazuara në ndarjen e pushtetit dhe në të cilat gjyqësori është i pavarur nga dy pushtetet tjera.

20.2. Parimet ndërkombëtare mbi gjykatat

Për shkak të natyrës jopolitike, te pushteti gjyqësor është më lehtë të ndërtohen parimet e përgjithshme që pranohen nga shumica e shteteve të botës, krahasuese me dy pushtetet tjera politike. Nga marrëveshjet, instrumentet dhe dokumentet tjera ndërkombëtare të ratifikuara dhe përqafuara, me fillim

[213] Cf. Jane Stromseth, David Whippman and Rosa Brooks, *Can Might Make Rights? Building the Rule of Law After Military Interventions* (Cambridge University Press: Cambridge, 2006), fq. 68-77.

nga **Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut** (DUDNJ), **Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike** (PNDCP) deri te **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut** (KEDNJ), parimet themelore mbi gjyqësorin janë shkrirë (kthyer) në të drejtën nacionale të shteteve sovrane dhe të pavarura. Në të njëjtën kohë, disa prej postulateve të tyre kanë gjetur vend në kushtetutat nacionale, kështu që dyfish janë bërë burime të së drejtës kushtetuese.

Parimi themelor fillestar ndërkombëtar është se **të gjithë janë të barabartë para gjyqit**. Mbi të drejtat dhe detyrimet si dhe mbi themeltësinë e aktakuzës kur personit duhet të vendos një gjykatë që ka kompetencë lëndore dhe territoriale, që është i pavarur, i paanshëm dhe që është i themeluar sipas ligjit. Njihen garancitë lidhur me procesin gjyqësor, në veçanti atë penal, të cilat i kontribuojnë gjykimit të drejtë dhe të paanshëm: publiciteti, prezumimi pafajësisë, legaliteti i veprës dhe sanksionit, e drejta në mbrojtje, çështja e gjykuar. Në veçanti theksohet gjykimi në kohë të arsyeshme, me të cilën nënkuptohet koha optimale brenda së cilës duhet të kryhet procedura gjyqësore. Kjo vlerësohet në secilin rast konkret, në secilën procedurë veç e veç dhe varet nga ndërlikueshmëria e rastit, sjellja e palëve dhe rrethanat tjera.

Parimi mbi të cilin ndërtohet themeli i pushtetit gjyqësor në shtetin bashkëkohor është parimi i **ndarjes së pushtetit**. Kjo nënkupton që vetëm pushteti gjyqësor është ai që ndan drejtësi në emër të kushtetutës, popullit, kurorës, shtetit, Zotit. Ndarja e pushtetit nënkupton edhe atë që vetëm gjykatat mund të ushtrojnë pushtetin gjyqësor. Pozita e gjykatës, si një organ që qëndron nën kushtetutë, është e veçantë në vendet ku gjykatat ushtrojnë edhe kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve. E veçanta konsiston në atë se në këto vende gjykatat interpretojnë kushtetutën dhe vendosin mbi atë se çfarë thotë norma juridike në rastin ose mosmarrëveshjen konkrete që zgjidhet së bashku me interpretimin kushtetues.

Parimi ligjshmërisë (legalitetit) nënkupton se gjykata është e nënshtruar ndaj ligjit, gjendet nën të drejtën të cilën e zbaton. Gjykata themelohet me kushtetutë ose ligj, gjykon sipas një procedure që normohet me ligj (e drejta procedurale) dhe zbaton normat ligjore dhe normat tjera në një rast ose mosmarrëveshje konkrete (e drejta materiale). Kjo nënkupton se nuk ka arbitraritet me rastin e themelimit të gjykatës dhe as gjatë punës së saj kurse vetë qëllimi i themelimit dhe punës së gjykatës nuk guxon të jenë politik. Nëse merret parasysh fakti se kushtetutën e ligjin i nxjerr (sjell) pushteti politik, atëherë hapet dilema lidhur me atë nëse gjykata, për shkak se themelohet me kushtetutë ose ligj dhe gjykon në bazë të tyre, gjendet nën vullnetin politik të këtij pushteti (kushtetutëbërës dhe ligjvënës)? Në kuptimin më të gushtë të fjalës, gjykata e tillë është, pra nën ndikimin e politikës, vetëm atëherë kur kushtetuta e ligji nuk mbrojnë liritë dhe të drejtat e njeriut. Prandaj, mund të thuhet se parimi legalitetit realizohet atëherë kur kushtetuta e ligjet shprehin vullnetin dhe interesin e përgjithshëm, mbrojnë lirinë, drejtat dhe barazinë e të gjithëve.

Parimi i pavarësisë nënkupton lirinë e gjykatës nga çfarëdo ndikimi nga jashtë, përkatësisht marrjen e vendimeve në mënyrë të pavarur. Ky parim mbron gjykatën nga ndërhyrja e një organi tjetër të pushtetit në punën e tij dhe nga ndikimi i subjekteve të tjerë vendorë dhe të huaj në gjykatë – grupet e interesit, korporatat, organizatat joqeveritare dhe kështu me radhë. Nga kjo, megjithatë, ekzistojnë përjashtime në formë të ndikimit të mëpastajmë (post festum) në vendimet e gjykatave përmes **faljes** dhe **amnistisë.**

Pavarësia e gjykatës si institucion i pushtetit (**pavarësia reale**) është parakusht i punës së pavarur, të ligjshme dhe të drejtë të gjyqtarit (**pavarësia personale**). I pavarur është ai gjyqtar që është i mbrojtur nga çdo ndikim nga jashtë. Puna e tij është e ligjshme kur në vendimmarrje i përmbahet normave juridike. I drejtë quhet ai gjyqtar që ruan objektivitetin pa marrë parasysh se kë gjykon ose lidhur me çfarë ka të bëj rasti që gjykon. Ligjshmëria e gjykimit nënkupton edhe të drejtën e gjyqtarit për moszbatim të ligjit ose normës në një kontest konkret, nëse dyshon që ligji ose norma është jokushtetuese, deri në momentin kur gjykata kushtetuese të thotë fjalën e vetë lidhur me kushtetutshmërinë e ligjit ose normës.

Parimi i pavarësisë përfshinë edhe **mëvetësinë organizative të gjykatës**, përkatësisht **pavarësinë institucionale** të gjykatës. Gjykatat kanë organizimin e tyre të brendshëm, kryetarin dhe administratën. Gjykatat janë të ndara në pikëpamje organizative dhe fizike nga ligjvënësi, ekzekutivi dhe administrata shtetërore, gjenden në një objekt të veçantë prej tyre. Zbatimi i mëtejmë i parimit të pavarësisë dhe mëvetësisë organizative të gjykatës shihet edhe brenda vetë sistemit të drejtësisë, ku gjykatat ndahet nga prokuroria publike, në aspektin e kompetencës, dhe në atë organizativ.

Ndarja e pushtetit gjyqësor dhe pavarësia e tij gjejnë vazhdimin e tyre në **parimin e detyrueshmërisë së vendimeve gjyqësore**. Pas këtij detyrimi qëndron monopoli i dhunës shtetërore, pa të cilin nuk do të ekzistonte rendi juridik dhe as sistemi gjyqësor. Me vendime gjyqësore mund të detyrohet çdo person fizik dhe juridik, person privat ose publik. Çdo kush detyrohet të zbatoj vendimin gjyqësor: dallohen ato që detyrojnë në rend të parë palët në kontest (**inter partes**) nga ato që kanë efekt të përgjithshëm, pra ndaj të gjithëve (**erga omnes**).

Parimi unitetit të sistemit gjyqësor nënkupton që të gjitha gjykatat janë pjesë përbërëse e një tërësie të pandarë. Në sistemin gjyqësor hyjnë gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatat e juridiksionit të posaçëm, të cilët në të njëjtën kohë janë në nivele të ndryshme të hierarkisë mes tyre, i larti dhe i ulëti. Në maje të sistemit gjyqësor gjendet gjykata supreme ose e kasacionit. Uniteti i sistemit gjyqësor nënkupton kërkesën për harmonizim të praktikës gjyqësore, qëndrime (pikëpamje) të njëjta të gjykatave në situata të ngjashme.

Parimi i përhershmërisë së gjykatave nënkupton që pushtetit gjyqësor është kategori kushtetuese dhe që gjykatat themelohen me ligj ose (pak më rrallë) me kushtetutë. Kompetenca gjyqësore dhe procedura normohen me ligj dhe rregulla të brendshme të gjykatave. Kjo nënkupton që nuk mund të themelohen gjykata jashtë sistemit, gjykata të jashtëzakonshme, të fshehta, të përkohshme dhe politike, dhe as nuk mund të ketë arbitraritet gjatë procedurës gjyqësore dhe me rastin e vendosjes.

Parimi i shkallshmërisë (dyshkallshmërisë dhe treshkallshmërisë) nënkupton që gjykatat e larta kontrollojnë vendimet e gjykatave më të ulëta, me qëllim të mënjanimit të lëshimeve (gabimeve). Parakusht për realizimin e këtij parimi është që të ekzistoj ndarja vertikale e gjykatave sipas rangut të tyre – rangu i ulët, i lartë dhe suprem i gjykatave. Vendimet e gjykatave të shkallës së parë nuk janë të formës së prerë nëse ndaj tyre ushtrohet mjeti juridik i goditjes. Apeli është gjykatë e shkallë së dytë sipas ankesës (apelit) ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë. **Gjykata e Kasacionit** është gjykata më e lartë që vendos në shkallë të fundit, ai gjykon mbi të drejtën jo faktet (nuk nxjerr fakte). Kjo gjykatë quhet edhe Gjykatë Supreme, e cila dallon nga kasacioni për shkak se, në raste të jashtëzakonshme, mund të gjykoj edhe pas nxjerrjes së provave (pra, përjashtimisht, mund të veproj edhe si gjykatë e faktit). Në parim, **Gjykata Supreme** ka rol **nomofilaktik**, përkatësisht kujdeset për zbatimin unik të ligjit në nivel vendi.

Kontrollimi i vendimeve të gjykatave të ulëta nga gjykatat më të larta ekziston me qëllim të konstatimit të të vërtetës gjyqësore. Kjo e vërtetë është fitim i njohurive mbi rastin që është objekt shqyrtimi dhe vendosjeje, që arrihet përgjatë procedurës gjyqësore. **E vërteta gjyqësore** që konstatohet nga gjykatat e larta konsiderohet e vërteta përfundimtare.

Me **parimin e pavarësisë materiale**, gjykatave iu garantohen mjetet për kryerjen e rregullt të punëve dhe ushtrimin e kompetencave të tyre. Kjo nënkupton se gjykatat kanë buxhetin e tyre, zakonisht edhe statusin e personit juridik. Shpenzimet e gjykatës dhe të gjykimit – pagat e të punësuarve, shpenzimet materiale, shpenzimet e palëve në procedurë i paguajnë shtetet ose njësitë federale si themelues të tyre. Gjykatat kanë të ardhurat e tyre nga taksat gjyqësore, vërtetimi i dokumenteve, lëshimi i vërtetimeve, certifikatave dhe dokumenteve të ndryshme. Lidhur me shpenzimet, çdo ditë e më shumë gjen**ë** vend parimi i ekonomizimit të procedurës, që nganjëherë shtyp edhe parimin e të vërtetës gjyqësore

që vërtetohet në gjykim. Në këtë kuptim, legjislacioni njeh mundësitë e përfundimit të gjykimit me marrëveshje mes palëve, jo vetëm në procedurë civile: në procedurë penale ka gjetur dhe po gjen zbatim jashtëzakonisht të madh. Në këtë mënyrë, procedura penale as që vjen në fazën përfundimtare, në gjykimin në shqyrtim kryesor të rastit (çështjes), por përfundon në procedurën penale paraprake. Kjo bën që të ketë shumë më pak shpenzime dhe, me këtë, të vjen deri të transformimi i kuptimit të së vërtetës gjyqësore: tani ajo nënkupton të vërtetën e konstatuar pa administrim të provave, por me marrëveshje; në këtë kuptim mund të thuhet se ekziston e ”vërteta sipas marrëveshjes”. Kjo praktikë, e marrë nga sistemi amerikan i drejtësisë, flet dhe vërteton mendimin që thotë se në **SHBA**, sistemi drejtësisë, me mbi 50.000 gjyqtarë, do të rrënohej si kullë prej letre në mungesë të institutit të **marrëveshjes për pranim të fajësisë**, mes prokurorit dhe mbrojtjes (i njohur si ”plea bargaining”). Përqindja e procedurave gjyqësore që mbarojnë me marrëveshje është i ndryshëm në shtetet e **ShBA-së**, por në përgjithësi është shumë i lartë: prej 70 deri 90 % **të krejt lëndëve përfundojnë me marrëveshje.**[214]

20.3. Statusi juridik i gjyqtarëve

Gjyqtarët janë funksionarët më të lartë shtetërorë brenda degës së pushtetit gjyqësor, të cilët kryejnë punët e gjykimit. Statusin e tyre juridik të funksionarëve të pavarur e përbëjnë shumë elemente. Për pavarësinë e gjyqtarëve të rëndësisë primare janë:

- mënyra e zgjedhjes apo caktimit të tyre;
- perfomanca e funksionit gjyqësor;
- palëvzishmëria;
- imuniteti;
- siguria materiale; dhe
- papajtueshmëria e funksionit (konflikti interesit).

Mënyra e zgjedhjes apo e caktimit të gjyqtarëve është një element shumë i rëndësishëm i statusit të pavarur të gjyqtarëve. Kjo është kështu jo vetëm nga shkaku se ky është kusht fillestar dhe thelbësor, por sepse që nga ky hap, hapi i parë, mund të ushtrohet ndikim vendimtar në gjyqtarë përmes imponimit të kushteve të përshtatshmërisë së tyre politike, gjë që do dominonte punën e tyre në të ardhmen. Nuk ekziston një formë përgjithësisht e pranuar dhe më e mira për zgjedhje apo caktim të gjyqtarëve. Për këtë arsye, procedurat janë të ndryshme, me fillim nga ato që synojnë përjashtimin e çdo ndikimi politik në përzgjedhjen apo caktimin e gjyqtarëve deri te e kundërta e kësaj – përzgjedhja apo caktimi politik i gjyqtarëve ngjashëm me parlamentarizmin. Në procedurën e zgjedhjes apo caktimit të gjyqtarëve duhet të vlerësohen kriteret që çojnë në përzgjedhjen ose caktimin e gjyqtarëve më të mirë. Kjo nënkupton se në përzgjedhjen ose caktimin e gjyqtarëve nuk vihet theksi te **legjitimiteti**, siç është rasti me zgjedhjen e përfaqësuesve në parlament ose zgjedhjen e presidentit, por te **kompetenca**, përkatësisht **profesionalizmi i kandidatit**.

Njëra nga mënyrat e vjetra të përzgjedhjes së gjyqtarëve është **shorti**. Këtu theksi vihet te objektiviteti i gjyqtarit që është përzgjedhur me short për gjykimin e rastit konkret. Kësisoj, në Athinën e vjetër,

[214] Cf. më shumë në Jennifer L. Mnookin, “Review: Uncertain Bargains: The Rise of Plea Bargaining in America Reviewed Work: *Plea Bargaining's Triumph: A History of Plea Bargaining in America* by George Fisher”. *Stanford Law Review* Vol. 57, No. 5, 2005 *Stanford Law Review Symposium: The Civil Trial: Adaptation and Alternatives* (April, 2005), fq. 1721-1743; Emilio C. Viano, “Plea Bargaining in the United States: a Perversion of Justice“. *Revue internationale de droit pénal* **Vol. 83 No. 1-2 (2012), fq. 109-145;** Ram Subramanian, Léon Digard, Melvin Washington II and Stephanie Sorage, *In the Shadows: A Review of the Research on Plea Bargaining* (The Vera Institute of Justice: New York, 2020) (ky raport jep statistikat më të fundit lidhur me gjendjen e marrëveshjes për pranim të fajsisë). Në internet: https://www.vera.org/publications/in-the-shadows-plea-bargaining (shikuar më 9 janar 2023).

kolegji gjykues ka fituar të drejtën për gjykim me tërheqjen e shortit në ditën e gjykimit. Gjyqtarë potencial kanë qenë qytetarët athinas, të cilët janë lajmëruar ditën e gjykimit në treg, në të cilin edhe është zhvilluar gjykimi.

Sot gjyqtarët zgjidhen ose caktohen organet e pushteteve të tjera apo trupa të veçanta. Parlamenti zgjedh gjyqtarët, i emëron shefi shtetit (Franca) ose ministri drejtësisë (Gjermania), zakonisht me propozim të një trupi profesional të posaçëm që veç ka bërë përzgjedhjen e më shumë kandidatëve. Te ky lloj i zgjedhjes nuk mund të përjashtohet në tërësi ndikimi politik. Zgjedhja nga trupat e zgjedhur nga vetë gjyqtarët (këshilli magjistraturë,s, këshilli gjyqësor etj) garanton objektivitet më të madh në përzgjedhjen e gjyqtarëve profesional (Italia, Portugalia). Këtij modeli mund t'i bëhen vërejtje sepse **nuk gëzon legjitimitet popullor** ngaqë zgjidhet nga një trup tërësisht profesional kolegjial, që mund të çoj në tjetërsimin e pushtetit gjyqësor nga populli ("kauterizimi"). Një mënyrë e veçantë e zgjedhjes është bazuar në **suksesin e gjyqtarëve** në shkollat e posaçme për gjyqtarë (në Francë shkolla e posaçme për magjistraturë, në SHBA shkolla e veçantë për trajnim të gjyqtarëve, në Greqi shkolla nacionale për gjyqtarë etj.). Në disa shtete **kombinohen mënyrat e ndryshme** për zgjedhjen ose caktimin e gjyqtarëve. Kështu, ta zëmë, në një numër të shteteve në **SHBA** gjyqtarët **zgjidhen në zgjedhje të drejtpërdrejta**, siç zgjidhen anëtarët e parlamentit (31 shtete), në të tjerat ata zgjidhen nga parlamentet e shteteve por **emërohen nga guvernatorët e shteteve**; edhe në **Zvicër**, gjyqtarët në nivel të kantoneve mund të zgjidhen nga populli. Ka vende kur përgatitjet për profesionin e gjyqtarit bëhen sipas **sistemit mentorial** (Austria, Gjermania), sistemit të **trajnimit të veçantë** nëpër shkolla ose akademi të drejtësisë (Franca, Portugalia, Spanja), ose ekziston sistem i kombinuar (Holanda, Italia). Para zgjedhjet ose caktimit, gjyqtarët në pjesën dërmuese të vendeve duhet të kenë të kryer provimin përkatës profesional.

Permanenca e funksionit gjyqësor nënkupton që gjyqtari zgjidhet ose caktohet vetëm njëherë, më pastaj e ushtron funksionin si gjyqtar në kohë të pacaktuar, deri në plotësimin e kushteve të përcaktuara me kushtetutë dhe ligj për ndërprerjen e funksionit në fjalë. Ato kushte zakonisht kanë të bëjnë me sa vijon: realizimi i të drejtës për pension, dorëheqja, shkarkimi, paaftësia e përhershme për punë. Permanenca e funksionit të gjyqtarit është e domosdoshme për kryerjen e një pune të pavarur, ligjore dhe kualitative. Ky kusht reflekton një sfidë jetësore dhe ftesë për orientim jetësor të individit si gjyqtar, ku gjyqtari profesionalisht ndërton dhe perfeksionon vetveten dhe, për pasojë, edhe punën që bën. Permanenca e funksionit gjyqësor nuk varet nga rezultatet e zgjedhjeve në zgjedhjet parlamentare ose presidenciale, sepse nuk ka skadim të mandatit dhe rizgjedhje të gjyqtarëve. Ky kusht zbutet në rastet kur ekziston një **afat provues për gjyqtarët fillestar** (tri vjet në Gjermani, Gjeorgji), pas kalimit të të cilit, nëse ka punuar mirë dhe ka ushtruar në mënyrë cilësore detyrën, zgjidhet gjyqtar me mandat të përhershëm. Duhet thënë se, megjithatë, zgjedhja e përkohshme e gjyqtarëve fillestarë cenon pavarësinë e tyre.

Një gjyqtarë mund të ndikohet jo vetëm me kërcënimin për humbje të funksionit, por edhe me transferimin e gjyqtarëve nga një gjykatë në tjetrën. **Palëvzishmëria** (jotransferimi) i gjyqtarëve nënkupton që gjyqtarët nuk mund të transferohen nga një gjykatë në tjetrën pa pëlqimin e tyre. Përjashtim bëjnë situatat kur transferi i gjyqtarit bëhet përkohësisht në një gjykatë që nuk është e largët nga gjykata amë dhe bëhet fjalë për vëllim të shtuar të punëve në gjykatën ku transferohet gjyqtari. Rrethanat e ndryshme, siç janë, ta zëmë, heqja dhe ndryshimi i gjykatës apo e një pjese të kompetencave të saj, si pjesë e riorganizimit të sistemit gjyqësor, mund të çojnë në transferin e gjyqtarëve. Këto rrethana, megjithatë, janë objektive dhe nuk konsiderohet që shkelin parimin e palëvizshmërisë së gjyqtarëve.

Në lidhje të ngushtë me pavarësinë e gjyqtarëve është edhe institucioni i **imunitetit**. Gjyqtari sjell vendime në bazë të gjendjes së konstatuar faktike dhe vlerësimit të lirë gjyqësor, që nuk është asgjë tjetër pos liri e mendimit me rastin e gjykimit. Për këtë arsye gjyqtari duhet të jetë i mbrojtur nga

përgjegjësia për mendimin e shprehur dhe qëndrimin e mbajtur me rastin e dhënies së gjykimit. Kjo garantohet me **imunitetin material**. Gjyqtarin e mbron **imuniteti procedural** nga ndjekja penale dhe burgosja për veprimet e ndërmarra gjatë ushtrimit të funksionit gjyqësor. Kjo mbrojtje mund të jetë më e gjerë dhe të barazohet me imunitetin e deputetit. Mbi heqjen e imunitetit të gjyqtarit vendos parlamenti ose organi i posaçëm i drejtësisë – këshilli i lartë i magjistraturës, këshilli gjyqësor, këshilli drejtësisë etj.

Që gjyqtari të ketë kushte dhe hapësirë për punë të pavarur nevojitet që të përcaktohen qartë rrethanat që shkaktojnë **papajtueshmërinë e funksionit** të gjyqtarit me funksionet dhe punët tjera (**konflikti interesit**). Gjyqtarët mund të ushtrojnë vetëm veprimtarinë gjyqësore, duke zbatuar me besnikëri kushtetutën dhe ligjin. Ndalohet që, krahas detyrës së gjyqtarit, të ushtrohet ndonjë funksion tjetër shtetëror, publik ose ndonjë shërbim tjetër profesional. Me këtë standard mbrohet **objektiviteti** në ndarjen e drejtësisë. Konflikti i interesit ka efekt më të butë kur bëhet fjalë për gjyqtarët porotë, të cilët nuk janë gjyqtarë të profesionit, profesionistë.

Papajtueshmëria e funksionit gjyqësor me funksionet tjera ka efekt edhe ndaj anëtarësisë së gjyqtarit në shoqata të ndryshme të qytetarëve, nga ato profesionale deri te ato me karakter politik. Në këtë drejtim, zgjidhjet janë të ndryshme, nga ato që gjyqtarin nuk e lejojnë të jetë anëtar i shoqatës (**Spanja**) deri te ato që lejojnë anëtarësimin e gjyqtarëve në sindikatat e shumta të gjyqtarëve (katër në **Francë**) dhe në shoqatat profesionale, anëtarësimin në partinë politike që e kandidon për gjyqtar (disa njësi federale në **SHBA**). Në shtetet evropiane është standard që gjyqtari nuk guxon të jetë anëtar i partisë politike dhe as nuk mund të merret me aktivitete politike.
Funksioni gjyqësor është një funksion që i sjell gjyqtarit një **siguri materiale**. Kjo nënkupton që gjyqtarët nuk janë vullnetarë, por jetojnë nga puna e tyre profesionale (gjyqtarët e paqes në **Angli**, që gjykojnë rastet me vlerë të vogël në sfera të caktuara, nuk kanë rrogë por fitojnë kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe disa kompensime të tjera materiale). Pavarësia e gjyqtarit në punë duhet të mbrohet edhe nga aspekti material, që do të thotë se gjyqtari duhet të ketë siguri të tillë ekonomike që mundëson përkushtimin e tërësishëm ndaj punës së gjyqtarit, pa pasur nevojë për të ardhura të tjera shtesë. Realizimi i këtij parimi, megjithatë, varet nga pasuria e shtetit, gjendja ekonomike në të.

20.4. Parimet procedurale si garancione të pavarësisë së gjykatës

Për realizimin e pavarësisë së gjykatave, përveç parimeve që kanë të bëjnë me pozitën e gjykatave (parimet materiale) dhe garancive mbi statusin juridik të gjyqtarëve, me aktet më të larta juridike garantohen disa parime që kanë të bëjnë me vetë gjykimin. Ato ngërthejnë vlera që janë ndërtuar në mënyrë graduale, me zhvillim juridik, kulturor dhe përgjithësisht me përparim civilizues. Shumica e këtyre parimeve kanë ekzistuar edhe në të kaluarën, siç është rasti me të drejtën për mbrojtje dhe gjykim publik, kurse aktualisht janë përpunuar proceduralisht dhe sanksionuar në nivelin më të lartë juridik – nivelin kushtetues.

Parimi i gjykimit publik nënkupton se ai nuk është i mbështjellë me sekrete, nuk ka mistikë në gjykim: në të mund të marrin pjesë përveç palëve në procedurë edhe personat e tretë. Bëhet fjalë për persona që janë të interesuar personalisht për rezultatin e procedurës gjyqësore. Parimi i gjykimit publik pëson kufizime teknike për shkak të madhësisë së sallës së gjykimit dhe sigurisë në të, që do të thotë se në disa raste nuk mund të marrin pjesë në gjykim krejt ata që dëshirojnë. Ky parim shërben si një garancion që gjyqtari nuk do të keqpërdor të drejtën e vet për të gjykuar në një rast ose mosmarrëveshje konkrete, as pushtetin që posedon për të vendosur mbi liritë dhe pasuritë apo interesat e të tjerëve. Përveç kësaj, parimi punës publike shkon në dobi të realizimit të parimit të ligjshmërisë së punës së gjyqtarit dhe, në të njëjtën kohë, forcon besimin e qytetarëve në gjyqësi. Veprimi i këtij parimi ndikon në qytetarë për të kuptuar më mirë drejtësinë dhe të drejtën, veprimet e lejuara dhe të ndaluara ligjërisht, për shkak se marrin informata mbi atë se çfarë është e drejta në një rast konkret.

Prania e publikut ndikon edhe në vet gjyqtarët. Ajo është motiv dhe detyrim për gjyqtarin që të studioj mirë lëndën dhe të merr vendim në një afat të arsyeshëm. Në të kundërtën, gjyqtari i nënshtrohet kritikave të opinionit publik dhe do të jetë objekt i kontrollit të posaçëm të punës së bërë, që mund të çoj në shkarkimin nga funksioni i gjyqtarit.

Parimi i gjykimit publik nuk është një **parim absolut**, nuk vepron ndaj secilit rast dhe në çdo rrethanë. Me ligj përcaktohen situatat dhe rastet kur gjatë gjykimit publiku përjashtohet, përkatësisht kufizohet. Arsyet për këtë janë të ndryshme: interesi i kryesit të mitur të veprës penale, interesi i viktimës së veprës penale, sekreti shtetëror ose ushtarak, siguria e shtetit, shqetësimi opinionit publik, mbrojtja e dëshmitarëve.

Parimi gjykimit kolegjial që nënkupton gjykim të përbashkët, të gjykuar nga trupi gjykues. Gjykimi nga trupi gjykues potencialisht shërben si një garancion për objektivitetin e gjykimit, konstatimit të tërësishëm të gjendjes faktike, vlerësimit të drejtë të fakteve dhe zbatimit të saktë të së drejtës materiale. Trupi gjykues përbëhet së paku prej tre gjyqtarëve. E përbëjnë në të njëjtën kohë gjyqtarët profesionalë dhe gjyqtarët porotë, apo vetëm gjyqtarët profesionalë. Në lëndët me peshë më të vogël – veprat e lehta penale, kundërvajtjet, kontestet me vlerë të vogël – i gjykon gjyqtari vetëm që është gjyqtar profesionist, vetëm përjashtimisht mund të jetë laik (në Britaninë e Madhe: "lay magistrates").

Me parimin e gjykimit kolegjial lidhet e drejta e qytetarëve për të marrë pjesë në gjyqësi dhe atë në formë të **porotës**. Marrja pjesë e joprofesionistëve, laikëve në drejtësi, në procedurë gjyqësore arsyetohet me atë që te qytetarët e zakonshëm ndjekja e drejtësisë dhe për të drejtën nuk e ka ngarkesën e formalizmit juridik. Në thelb të këtij arsyetimi qëndron ajo se ata pengojnë tjetërsimin e gjykatave nga populli, shndërrimin e gjykatave në një qark të mbyllur juristësh, në një shoqëri të ndihmës reciproke. Në sistemin anglosakson të gjyqësisë, porota është i ndarë nga gjyqtari. Porota ekziston në materien penalo-juridike dhe vendos për fajësinë – nëse i pandehuri, në bazë të provave të administruara, është fajtor ose jo ("guilty or not guilty"). Nëse porota vendos që ekziston fajësia, atëherë gjyqtari vendos për llojin dhe lartësinë e dënimit. Në **sistemin e përzier të porotës**, gjyqtarët profesionalë dhe gjyqtarët porotë vendosin së bashku për fajësinë dhe dënimin, në mënyrë të barabartë.

Objektiviteti i gjykimit mbrohet me të drejtën për gjyqtarin e radhës: që gjyqtari të jetë i paanshëm, ajo/ai duhet të pranoj lëndët sipas radhitjes së tyre. Dikur ky parim është vënë në jetë përmes tërheqjes së shortit nga gjyqtarët që do të gjykojnë rastin, kurse sot administrata e gjykatës ngarkon me lëndë gjyqtarët sipas radhës së arritjes së tyre në gjykatë. Me këtë parim, pra me parimin që lëndën e gjykon gjyqtari radhës, lidhen edhe rregullat mbi përjashtimin e gjyqtarit. Nga gjykimi përjashtohet gjyqtari që ka një marrëdhënie me palët dhe lëndën, që mund të ndikoj në paanësinë në gjykim dhe vendosje të rastit konkret. Në një rast të tillë, lënda i ndahet gjyqtarit të ri, ose i dërgohet gjykatës tjetër me kompetencë lëndore të njëjtë.

Një mori të drejtash kushtetuese dhe ligjore të natyrës procedurale ekzistojnë në favor të palëve dhe ndikojnë në punën e pavarur të gjykatave. Këtu mund të veçohen disa nga më të rëndësishmet: **e drejta për mbrojtje**, **e drejta për vendim të arsyetuar gjyqësor** dhe **e drejta për ankesë**. E drejta për mbrojtje në gjyq është një e drejtë themelore njerëzore. Qytetari ka të drejtë të mbrohet vet, nëse dëshiron një gjë të tillë ose nuk ka mjete materiale, por mund të angazhoj një mbrojtës (avokat). E drejta për mbrojtje përfshinë edhe të drejtën për angazhim të mbrojtësit në shpenzime të shtetit, sipas detyrës zyrtare. E drejta për vendim të arsyetuar gjyqësor dhe e drejta për ankesë janë të lidhur proceduralisht. E drejta për paraqitjen e ankesës si mjet goditjeje mund të realizohet për shkak se gjyqet kanë organizim hierarkik, nga shkalla e parë deri te shkalla e tretë. Për paraqitjen e ankesës së arsyeshme duhet të ekzistoj një arsyetim i vendimit gjyqësor. Në arsyetim të vendimit gjykata tregon se me cilat fakte, prova dhe norma juridike është udhëhequr kur ka marrë vendimin që goditet me mjet juridik, përkatësisht ankesë. Pikërisht ato janë edhe arsyet për paraqitjen e ankesës.

20.5. Organizimi i pushtetit gjyqësor

Pushteti gjyqësor çdo herë është i përbërë nga disa gjykata. Ato ndahen sipas hierarkisë dhe llojit të rasteve që vendosin (**kompetenca lëndore**) dhe në bazë të territorit brenda të cilit gjykojnë dhe vendosin rastet (**kompetenca territoriale**). Në rangun më të ulët gjendet gjykata e shkallës së parë, e cila është kompetente për gjykim dhe vendosje të rasteve në një territor më të vogël – komunat, pjesë të qytetit, qyteti. Gjykata mbi të ka kompetencë për gjykim dhe vendosje të rasteve në një hapësirë territoriale më të madhe, kurse gjykata supreme ose e kasacionit ka juridiksion për krejt territorin e shtetit.

Sipas llojit të rasteve që gjykojnë dhe vendosin, gjykatat ndahen në ato që kanë **kompetencë të përgjithshme** dhe në të tjerat që kanë **kompetencë të posaçme** (**specializuar**). Gjykatat e kompetencës së përgjithshme gëzojnë privilegjin e supozimit të kompetencës gjyqësore: gjykojnë krejt rastet përveç atyre që janë lënë në kompetencë të gjykatave të specializuara. Gjykatat e kompetencës së përgjithshme janë: gjykata e shkallës së parë (gjykata komunale, themelore), gjykata e shkallës së dytë (gjykata e lartë, e qarkut, rrethit, apelit) dhe gjykata supreme (e kasacionit).

Gjykatat e kompetencës së specializuar gjykojnë dhe vendosin për lëndët të cilat, për shkak të natyrës së tyre, përjashtohen nga kompetenca e gjykatave me kompetencë të përgjithshme. **Gjykatat administrative** gjykojnë dhe vendosin rastet administrative që kanë të bëjnë me aktet përfundimtare administrative. **Gjykatat ekonomike** (tregtare) gjykojnë rastet që lindin mes subjekteve ekonomike dhe shqiptojnë sanksione për delikte ekonomike (veprime të ndaluara ligjërisht në jetën ekonomike). **Gjykatat kundërvajtëse** gjykojnë rastet e kundërvajtjeve, të cilat janë vepra të ndëshkueshme, por më të lehta sesa veprat penale. **Gjykatat ushtarake** gjykojnë dhe vendosin për veprat penale kundër forcave të armatosura dhe veprat që i kryejnë pjesëtarët e ushtrisë. Kompetenca e gjykatave ushtarake gjatë kohës së luftës mund të zgjerohet, sa i përket numrit të veprave penale dhe qytetarëve si kryes potencial të tyre.

Gjykatat zgjedhore gjykojnë dhe vendosin për rastet lidhur me zgjedhjet, siç janë: shkelja e të drejtave zgjedhore, shkelja e rregullave të procedurës zgjedhore. **Gjykatat fetare**, kryesisht gjykatat e sheriatit, gjykojnë dhe vendosin për rastet civile sipas rregullave të posaçme (Kurani, hadithet etj.). **Gjykatat për të mitur** gjykojnë rastet kur të miturit janë kryes të veprës penale. **Gjykatat martesore dhe për statusin**, gjykatat e paqes, gjykojnë kontestet lidhur me martesën dhe pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve. Mund të ekzistojnë **gjykata të posaçme tatimore dhe gjykata doganore**, të cilat gjykojnë dhe vendosin rastet e kundërvajtjeve tatimore dhe doganore. **Gjykatat e punës**, që dikur kanë ekzistuar edhe në ish-Jugosllavi me emrin ”gjykatat e punës së bashkuar”, gjykojnë kontestet lidhur me të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës. **Gjykata e posaçme e auditimit (ose mbi buxhetin)** kontrollon aktivitetin e shpenzimit të mjeteve publike, përkatësisht kontrollon derdhjet buxhetore dhe konstaton përgjegjësinë lidhur me këtë**. Arbitrazhat**, gjykatat e zgjedhura, janë lloje të posaçme të gjykatave në të cilat palët bartin të drejtën për të gjykuar dhe vendosur rastin e tyre eventual në të ardhmen, me vendimin e të cilave paraprakisht pajtohen.

Ekzistimi i gjykatave të kompetencës së përgjithshme kontribuon dukshëm në kualitetin e pushtetit gjyqësor, sepse gjyqtarët specializohet për llojin e caktuar të kontesteve. Brenda gjykatave të kompetencës së përgjithshme ekzistojnë departamente (seksione, degë) në të cilat caktohen gjyqtarët që gjykojnë lëndët penale, kontestimore, jashtëkontesimore, të ekzekutimit dhe lëndët administrative. Kjo mund të konsiderohet si specializim i brendshëm i punës me qëllim të gjykimit dhe vendosjes kualitative.

Gjykatat e kompetencës së përgjithshme dhe të kompetencës së specializuar janë **gjykata të rregullta**. Kjo nënkupton se për to vlejnë në mënyrë të njëjtë rregullat materiale dhe procedurale mbi gjykatat, si dhe parimet që garantojnë statusin juridik të gjyqtarëve. Gjykatat e jashtëzakonshme, jo të rregullta, sipas rregullit janë kundërkushtetuese dhe janë të ndaluara. Në kushtet e luftës, kryengritjes dhe revo-

lucionit, megjithatë, ka ardhur deri te themelimi i gjykatave të jashtëzakonshme dhe të atypëratyshme, të cilat gjatë gjykimit dhe vendosjes në masë të vogël iu janë përmbajtur parimeve mbi gjykatat ose kanë injoruar në tërësi parimet themelore të drejtësisë dhe jurisprudencës, siç janë e drejta për mbrojtje, parimi i gjykimit publik, e drejta për ankesë dhe kështu me radhë.

21. Sistemi drejtësisë në Republikën e Kosovës: Historiku

Sistemi i drejtësisë në Kosovë ka një histori relativisht të gjatë. Në një fazë të zhvillimit të tij, ai ka qenë pjesë integrale e sistemit të drejtësisë të Republikës së Serbisë (1945-1969), për të qenë një sistem autonom i drejtësisë pas ngjizjes së autonomisë së Kosovës në kuadër të ish-Jugosllavisë, që nis me nxjerrjen e **Ligjit Kushtetues të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KSAK) në vitin 1969**, autonomi që kompletohet me nxjerrjen e Kushtetutës së **KSAK-së** të vitit 1974. Në seksionet e fundit në vijim të këtij kapitulli flasim për gjyqësinë kushtetuese dhe historikun e saj, e cila asnjëherë nuk ka qenë pjesë e gjyqësisë së rregullt të Kosovës, konform modelit kelsenian/evropian të gjyqësisë kushtetuese. Këtu, në këtë seksion, bëjmë fjalë vetëm për sistemin e drejtësisë së rregullt, i cili ka pasur jetë të zakonshme sikur edhe sistemi i drejtësisë në ish-republikat jugosllave dhe në Krahinën e Vojvodinës. Ky sistem, së bashku me gjyqësinë kushtetuese, formalisht ka marrë fund më 23 mars 1989, në ndërkohë që degjenerimi i tij ka nisur në mënyrë graduale nga viti 1981, pas demonstratave të 11 marsit 1981, kur populli i Kosovës masivisht u ngrit në këmbë për të kërkuar statusin e republikës në kuadër të ish-Jugosllavisë, status të njëjtë që gëzonin njësitë tjera federale. Pas kësaj kohe, sistemi i drejtësisë u politizua dhe i shërbeu politikës ditore, që diktohej nga hegjemonia serbe, deri në rrënimin e tërësishëm të tij më 23 mars 1989. Kjo datë koincidon edhe më rrënimin formal të gjyqësisë kushtetuese në Kosovë. Pas kësaj, sistemi i drejtësisë në Kosovë në tërësi integrohet me sistemin e drejtësisë në Serbi, nën diktaturën serbe të prirë nga lideri serb **Sllobodan Millosheviq** (Slobodan Milošević: 1941-2006). Pas hyrjes së trupave të **NATO**-s në Kosovë dhe instalimit të administratës ndërkombëtare, më 10 qershor 1999, nis një fazë e re në zhvillimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë, fazë që ka zgjatur deri me shpalljen e pavarësisë së vendit më 17 shkurt 2008.

Nga sa më sipër shihet qartë se në zhvillimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë dallohen tri periudha: e para, deri në nxjerrjen e Ligjit Kushtetues të KSAK-së (1969); e dyta, nga ky vit e deri më 23 mars 1989, kur vjen deri te rrënimi i autonomisë së Kosovës; e treta, faza e sistemit të drejtësisë nën patronatin e **UNMIK-ut**; dhe, së fundi, sistemi i drejtësisë pas shpalljes së pavarësisë së vendit dhe zgjat deri më sot. Për shtjellimet tona të fazës së parë, që ka të bëjë me sistemin e drejtësisë nën **KSAK**, për burim primar kemi pasur studimin monografik të profesorit të ndjerë, **Kurtesh Salihu** (1940-2014), doajenit të së drejtës kushtetuese të shqiptarëve nën ish-Jugosllavi,[215] dhe librin e konstitucionalisit më të njohur serb të kohës, profesorit **Jovan Gjorgjeviq** (Jovan Đorđević: 1908-1989), versioni shqip dhe në gjuhën serbe.[216]

21.1. Sistemi drejtësisë deri më 1969

Në Kuvendin e dhunshëm të Prizrenit, që u mbajt më 8-10 korrik 1945, u mor vendim nën tytat e pushkës, që Kosova të organizohet si krahinë në gjirin e ish-Jugosllavisë dhe, si e tillë, të bashkohet në kuadër të Serbisë federale. Në këtë mbledhje u zgjodh organi më i lartë gjyqësor i Kosovës – Gjykata Krahinore e Kosovës dhe Metohisë, e njohur në diskursin e përditshëm si Gjykata Popullore e Krahinës. Kjo gjykatë ka shprehur, në ditët e para të funksionimit të autonomisë së Kosovës nën regjimin komunist, pavarësi po aq sa kanë shprehur gjykatat dhe krejt sistemi i drejtësisë në atë shtet komunist. Kosova shumë shpejt humb autonomitetin e saj në këtë sferë. Me ligjin mbi rregullimin e gjykatave popullore, të cilin e nx-

[215] Kurtesh Salihu, *Lindja*, *zhvillimi*, *pozita dhe aspektet e autonomitetit t*ë *Krahinës Socialiste t*ë *Kosovës në Jugosllavinë Socialiste* (Enti Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i KSAK: Prishtinë 1984).

[216] Jovan Gjorgjevic, *E drejta kushtetuese*, përkth. Kurtesh Salihu (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i KSAK: Prishinë, 1972) dhe Jovan Dordjevic, *Ustavno pravo* (Savremena administracija: Beograd, 1975).

jerr Kuvendi i Përkohshëm Popullor i Jugosllavisë Demokratike, më 25 gusht 1945, Gjykata Popullore e Kosovës e humb karakterin dhe pozitën e instancës më të lartë gjyqësore në Krahinë. Edhe pse edhe më tutje e mban emrin "Gjykata Krahinore e Kosovës dhe Metohisë", ajo shndërrohet në gjykatë me kompetenca të gjykatës së qarkut. Sa për krahasim, po me atë ligj, Krahina Autonome e Vojvodinës e mban Gjykatën Supreme të saj njësoj sikurse edhe republikat ish-jugosllave (sic!). Bazuar në ligjin si më sipër, Serbia edhe formalisht, me vendim, suprimon plotësisht këtë gjykatë. Në vend të saj, në Kosovë nga 30 dhjetori 1945 funksionojnë katër gjykata të qarkut. Në këtë periudhë, pra, funksionin gjyqësor në Kosovë e kanë ushtruar gjykatat e rrethit dhe gjykatat e qarkut, ndërsa Gjykata Supreme e Serbisë ka vlejtur si instancë e fundit gjyqësore edhe për Krahinën e Kosovës dhe Metohisë, siç quhej Kosova në atë kohë. Sikundër mund të shihet, që nga konstituimi i autonomisë së Kosovës më 1945 ka ekzistuar një sistem gjyqësor, por si pjesë përbërëse e sistemit gjyqësor serb. Vetëm shkurtimisht, me krijimin e Gjykatës Popullore të Krahinës, Kosova ka gëzuar një autonomi të kufizuar në sferën gjyqësore. Kjo gjendje në ndërkohë është sanksionuar me Kushtetutën e Serbisë të vitit 1947 dhe Ligjin Kushtetues të Serbisë të vitit 1953. Me Kushtetutën e ish-Jugosllavisë të vitit 1963, vjen deri të njësimi në emërtim i Kosovës me Vojvodinën – dyja quhen krahina autonome. Në sferën e sistemit gjyqësor, megjithatë, dy krahinat humbin autonominë: Vojvodina, që kishte gëzuar këtë autonomi që nga koha e Luftës së Dytë Botërore, e humb në tërësi me Kushtetutën e vitit 1963 të ish-Jugosllavisë. Sipas kësaj kushtetute, vjen deri të zbatimi i sistemit unik gjyqësor në krejt shtetin. Sistemi gjyqësor, sipas kushtetutës së vitit 1963, përbëhet prej gjykatave të kompetencës së përgjithshme gjykatat komunale, gjykatat e qarkut, gjykatat supreme të republikave, pra jo edhe të dy krahinave autonome, dhe Gjykata Supreme e Jugosllavisë, dhe gjykatave të specializuara. Sa i përket organizimit, federata, me anë të ligjit, ka rregulluar parimet themelore të rregullimit të brendshëm të gjykatave dhe ka formuar Gjykatën Supreme të Jugosllavisë, ndërsa republikat formojnë gjykatat supreme, gjykatat e qarkut dhe ato komunale.

Në pajtim me konceptin kushtetues të kohës, sipas të cilit krahinat autonome (e Kosovës dhe Vojvodinës) kanë kryer detyra të caktuara për Republikën e Serbisë në territoret e tyre, me Kushtetutën e Serbisë të vitit 1963 në krahinat autonome formohen degët e **GJSSerb**. Këto kreatura gjyqësore, të formuara në Novi Sad dhe Prishtinë, ushtronin në territorin e krahinave punët nga kompetenca e GJSSerb. Po këtë zgjidhje kushtetuese, të përcaktuar me Kushtetutën e Serbisë të vitit 1963, e hasim edhe në Statutin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë (Statuti ka qenë akti më i lartë juridik në Kosovë në këtë kohë), miratuar në vitin 1963. Kjo ka qenë e natyrshme sepse Statuti Krahinës në të shumtën e rasteve vetëm ka përsëritur dispozitat e Kushtetutës së Serbisë lidhur me krahinat autonome dhe ka derivuar nga ajo, pra nuk ka përcaktuar asnjë kompetencë origjinale të krahinës, sepse të tilla nuk ka pasur. Si për ironi, **KSerb**, aktualisht në fuqi, përcakton autonomi identike për Vojvodinën dhe Kosovën (sic!).

Gjyqtarët e këtyre degëve gjyqësore të GJSSerb i kanë zgjedhur dhe shkarkuar kuvendet e dy krahinave autonome. Po këto kuvende kanë shqyrtuar raportet e punës së këtyre degëve gjyqësore për territorin e tyre. Përveç degës së GJSSerb, në Kosovë në këtë kohë kanë funksionuar 17 gjykata komunale, tri gjykata të qarkut dhe një gjykatë ekonomike e qarkut. Përveç këtyre gjymtyrëve të pushtetit gjyqësor, kanë funksionuar edhe Prokuroria Publike e Krahinës, tri prokurori publike të qarkut dhe shtatë prokurori publike komunale, si dhe Avokatura Publike e Krahinës (një organ ky publik që ka mbrojtur interesat publike pranë gjyqeve dhe prokurorive të vendit).

21.2. Sistemi drejtësisë deri më 23 mars 1989

Pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 1969, me zgjerimin e funksioneve të Krahinës së Kosovës dhe pasurimin e autonomisë së saj, Kosova gati njëjtësohet me republikat jugosllave për nga funksioni i saj gjyqësor (me përjashtim të gjyqësisë që ka të bëj me realizimin e funksioneve unike për krejt territorin e Republikës së Serbisë, sepse Kosova atëbotë konsiderohej si pjesë përbërëse e Republikës së Serbisë). Në këtë drejtim, në këtë lëmë Kosova formon organet e gjyqësisë dhe rregullon organizimin dhe kompetencat e tyre. Kështu, pasi konstaton se funksionin gjyqësor në Krahinë e ushtrojnë gjykatat e kompetencës së përgjithshme,

gjykatat e specializuara dhe gjykatat e tjera, që themelohen në bazë të ligjit, Ligji Kushtetues i KSAK-së (e cila më nuk quhet ”Krahina Socialiste Autonome e Kosovës dhe Metohisë”, por vetëm KSAK), cakton se Krahina rregullon organizimin e gjyqësisë dhe ushtron funksionin gjyqësor brenda kompetencës që përcaktohet me kushtetutë dhe ligj (mendohet në kushtetutën e ish-Jugosllavisë dhe ligjin federativ).

Krahina, me Ligjin Kushtetues ka rregulluar pozitën dhe kompetencat e **GJSKos**, si gjykatë me të drejta dhe detyra të gjykatave supreme të republikave ish-jugosllave, si dhe pozitën e prokurorisë publike, ndërsa çështjet tjera, si dhe kompetencat e gjykatave të tjera, ia ka lënë ligjit. Në këtë periudhë, Krahina akoma nuk ka pasur gjykatën e vet të lartë ekonomike, si instancë gjyqësore të shkallës së dytë në Krahinë për gjykimin e kontesteve ekonomike dhe çështjet e tjera juridike me interes për ekonominë.

Ndryshimet kushtetuese të vitit 1971 e begatojnë edhe më tej autonomitetin e Krahinës. Ky begatim është evident edhe në sferën gjyqësore. Me amendamentin II për **Ligjin Kushtetues të KSAK-së**, me të cilin caktohen çështjet të cilat i rregullon Krahina me ligjet e veta, në mes tjerash, caktohen edhe gjykatat, arbitrazhi, këshillat e pajtimit, prokuroria publike, avokatura publike etj. Me zgjerimin e të drejtave të Krahinës në lëmin e ekonomisë, me Ligjin mbi organizimin dhe kompetencën territoriale të gjykatave ekonomike, më 1972 formohet **Gjykata e Lartë Ekonomike** në Prishtinë.

Me Kushtetutën e KSAK-së të vitit 1974, e cila rrumbullakon autonominë e Kosovës në sferën e sistemit të drejtësisë, përveç çështjeve që kanë qenë të rregulluara në mënyrë unike për krejt territorin e Republikës së Serbisë, që përfshinte edhe dy krahinat autonome, të Kosovës dhe Vojvodinës, përfundimisht përligjësohen kompetencat e të dy llojeve të gjykatave (të kompetencës së përgjithshme dhe gjykatat e specializuara), format në të cilat paraqiten këto gjykata, parimet për punën e gjykatave, të vendosurit në gjykata, pjesëmarrjen e laikëve si gjyqtarë, gjyqtarë të jurisë, pozitën dhe kompetencat e prokurorisë publike etj. Në pjesën mbi organet e Krahinës caktohen kompetencat e **GJSKos** dhe numërohen organet e tjera krahinore të drejtësisë, si Prokurori Publik i KSAK-së dhe Avokati Shoqëror i Vetëqeverisjes (ky organ ka qenë i ngjashëm më organin e Avokatit të Popullit). Kompetenca, përbërja dhe organizimi i këtyre organeve rregullohej me ligj. Tani përfundimisht në Kosovë ekzistonin gjykatat e kompetencës së përgjithshme dhe gjykatat ekonomike, në të gjitha nivelet. Si gjykata të llojit të parë kanë qenë gjykatat komunale dhe gjykatat e qarkut. Instanca më e lartë e gjyqësorit të rregullt ka qenë **GJSKos**. Në këtë kohë, në Kosovë kanë ekzistuar 17 gjykata komunale dhe 5 gjykata të qarkut me kompetencë të përgjithshme. Prej gjykatave ekonomike të qarkut kanë ekzistuar vetëm dy sosh, një në Prishtinë dhe tjetra në Gjakovë. Me ligjin mbi organizimin dhe kompetencën territoriale të gjykatave ekonomike ka qenë e themeluar edhe Gjykata e Lartë Ekonomike me seli në Prishtinë, e cila ka filluar punën më 1 tetor 1972, atë vit kur qe miratuar edhe ligji sipërcekur. Pas nxjerrjes së Kushtetutës së vitit 1974, kjo gjykatë shuhet dhe kompetencat e saj kalojnë në GJSKos, në një departament të posaçëm për konteste ekonomike. Me Kushtetutën e vitit 1974, krahas organeve të drejtësisë, si më sipër, në të gjitha nivelet janë themeluar edhe të a.q. gjykata e punës së bashkuar, që kanë zgjidhur kontestet nga marrëdhënia e punës nëpër ndërmarrje shoqërore dhe mosmarrëveshjet tjera tipike për sistemin socialist vetëqeverisës të asaj kohe. D.m.th., kanë qenë gjykata ideologjikisht të motivuara dhe janë futur në sistemin kushtetues jugosllav në vitin 1974. Në Kosovë kanë qenë dy sosh në shkallë të parë, një në Prishtinë e tjetra në Gjakovë, kurse në nivel të KSAK-së ka ekzistuar një gjykatë e punës së bashkuar.

Kjo strukturë e sistemit të drejtësisë në Kosovë formalisht ka ekzistuar deri më 23 mars 1989, kur Serbia rrënon autonominë e Kosovës dhe shkatërron çdo institucion që identifikohej me kushtetutën e vitit 1974.

21.3. Sistemi drejtësisë nën administratën UNMIK

Sistemi i drejtësisë në Kosovë nën administratën e UNMIK-ut hyn në radhën e sistemeve të ”hibridizuara” apo ”internacionalizuara” të drejtësisë. Njëjtë si me rastin e paneleve speciale gjyqësore në Timorin Lindor, gjykatën speciale në Sierra Leone dhe dhomat e jashtëzakonshme të Kamboxhias, në Kosovë është ndërtuar një sistem gjyqësor (dhe prokurorial) i përbërë nga gjyqtarë (dhe prokurorë) vendorë dhe ndërkombëtarë.

Për dallim nga tri rastet e sipërcekura të sistemeve të drejtësisë (**hibride** apo të **ndërkombëtarizuar)**, në rastin e Kosovës sistemi i drejtësisë ka marrë autorizimet e veta nga rregulloret e UNMIK, aktet juridike me fuqi më të lartë juridike në vend deri në shpalljen e pavarësisë më 17 shkurt 2008 (edhe pas saj deri në zëvendësimin e tyre me ligjet e vendit), autoriteti i të cilit në burim ka rrjedhur nga Rezoluta 1244 e KS të OKB-së, e nxjerrë në bazë të kapitullit VII të **Kartës së OKB**-së.[217] Ndër rregulloret më të rëndësishme që kanë qenë vendimtare në ndërtimin e kuadrit juridik të sistemit të drejtësisë nën administratën UNMIK-ut kanë qenë:

- Rregullorja nr. 1999/1 e datës 25 korrik 1999 mbi autoritetin e administratës së përkohshme në Kosovë;
- Rregullorja nr. 1999/24 e datës 12 dhjetor 1999 mbi të drejtën e aplikueshme në Kosovë;
- Rregullorja nr. 2000/1 e datës 14 janar 2000 mbi strukturën e përkohshme të përbashkët administrative;
- Rregullorja nr. 2001/8 e datës 6 prill 2001 mbi themelimin e KGJJ-së dhe KPK-së;
- Rregullorja nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001 ("Korniza kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme në Kosovë").

Pas datës 10 qershor 1999, kur instalohet administrata UNMIK në Kosovë, ndërkombëtarët kanë synuar të krijojnë një sistem të drejtësisë të paanshëm, të pavarur dhe multietnik. Për arritjen e këtij qëllimi, UNMIK-u është ndeshur me një ambient ku për dhjetë vjet me radhë nuk ka pasur praktikë të drejtësisë nga vendorët, përkatësisht ku sistemi i drejtësisë ka qenë brutal, represiv dhe ka pasur tiparet e një sistemi kolonial të pushtetit. Për këtë arsye, dy rregulloret e para kanë qenë të domosdoshme për të hapur rrugë ndërtimit të sistemit të ri të drejtësisë. Kjo nuk përbënte ndonjë problem në aspektin formalo-juridik, sepse **UNMIK**-u dhe **Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm** (PSPP) kanë qenë autoriteti më i lartë legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor në Kosovë: sipas nenit 1.1 të Rregullores 1999/1 "Gjithë pushteti legjislativ dhe ekzekutiv në lidhje me Kosovën, duke përfshirë administrimin e organeve të drejtësisë, i vishet **UNMIK**-ut dhe ushtrohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm". Kjo përforcohej edhe më shumë me dispozitën në vijim 1.2 të këtij akti juridik, që përcaktonte se "Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të emërojë dhe shkarkojë cilindo person për të kryer funksione në administratën civile në Kosovë, duke përfshirë edhe gjyqësinë. Këto funksione kryhen në pajtim me ligjet ekzistuese, ashtu siç përcaktohet në nenin 3 dhe me rregulloret e nxjerra nga **UNMIK**-u. Neni 3 i të njëjtit dokument bënte lidhjen me rendin juridik të **KSAK**-së, sepse mbante qëndrimin se e drejtë e aplikueshme ishte ajo që kishte qenë në fuqi më datën 23 mars 1989, por me disa kushte: "Ligjet e Kosovës të cilat kanë qenë në fuqi në territorin e saj para datës 24 mars 1999 do të vazhdojnë të zbatohen në Kosovë nëse nuk bien në kundërshtim me standardet e përmendura në nenin 2, me përmbushjen e mandatit të dhënë UNMIK-ut me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ose me këtë rregullore a çdo rregullore tjetër të nxjerrë nga UNMIK-u". Neni dy, ndërkaq, në mënyrë të përgjithësuar mëtonte të frenonte dhe eliminonte praktikat e shëmtuara nga e kaluara kur drejtësia kishte qenë diskriminuese, e varur dhe tërësisht e anshme: "Të gjithë personat që marrin përsipër detyra publike ose mbajnë funksione publike në Kosovë, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre duhet t'i respektojnë standardet e pranuara ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të mos diskriminojnë asnjë person për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, bindjes politike ose bindjeve të tjera, origjinës kombëtare, etnike apo sociale, shoqërimit me një komunitet kombëtar, pasurisë, lindjes ose të ndonjë statusi tjetër".

[217] Cf. më gjërësisht për sistemin e drejtësisë nën administratën **UNMIK**, me fokus të posacëm në sferën penale, në përmbledhjen e shkëlqyer të punimeve, botuar në librin e Cesare P.R. Romano, André Nollkaemper and Jann K. Kleffner (eds.), *Internationalized Criminal Courts: Sierra Leone, East Timor, Kosovo, and Cambodia* (Oxford University Press: Oxford 2004); Cf. gjithashtu edhe në librat e autorit kosovar **Hazër Susuri**: *E Drejta Kushtetuese e Republikës së Kosovës* (Kolegji "FAMA": Prishtinë, 2011); Themelimi i Shtetit të Kosovës: 1946-2008 (Kolegji "FAMA": Prishtinë, 2019), *E Drejta Kushtetuese* (Kolegji "FAMA ": Prishtinë, 2019).

Një akt tjetër juridik shumë i rëndësishëm për ndërtimin e sistemit të drejtësisë në këtë kohë është Rregullorja nr. 1999/24, e cila më tutje përpunon rregulloren si më sipër, sepse ka saktësuar edhe më shumë se çka nënkuptohet e drejtë e aplikueshme në Kosovë dhe nën cilat kushte. Sipas nenit 1 të kësaj rregulloreje, si ligj në fuqi në Kosovë konsideroheshin: (a) Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to dhe (b) Legjislacionin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989. Në rast konfliktesh mes tyre, mbizotëronin rregulloret e UNMIK dhe instrumentet tjera ndihmëse të nxjerra në përputhje me to (neni 1.1 i Rregullores nr. 1999/24). Në qoftë se një gjykatë e juridiksionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjislacionit, konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjislacioni i përcaktuar në paragrafin 1.1 të kësaj rregulloreje, por mbulohet nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues dhe është në përputhje me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, atëherë gjykata, organi ose personi, si përjashtim, e zbaton atë ligj (neni 1.2 i Rregullores nr. 1999/24). Dispozita e nenit 1.3 i kësaj rregulloreje ishte më e rëndësishmja sepse saktësonte parametrat e ligjshmërisë që duhej të ndërtohej në rendin e ri kosovar pas largimit të pushtimit serb nga Kosova: "Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, të gjithë personat me detyra publike ose që mbajnë pozita publike duhet të respektojnë standardet e njohura ndërkombëtare të të drejtave të njeriut siç pasqyrohen veçanërisht në: (a) Deklaratën universale të të drejtave të njeriut të 10 dhjetorit 1948; (b) Konventën evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut të 4 nëntorit 1950 dhe protokollet e saj; (c) Marrëveshjen ndërkombëtare për të drejtat qytetare dhe politike të 16 dhjetorit 1966 dhe protokollet e saj; (d) Marrëveshjen ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore të 16 dhjetorit 1966; (e) Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial të 21 dhjetorit 1965; (f) Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave të 17 dhjetorit 1965; (g) Konventën kundër torturës dhe keqtrajtimit çnjerëzor dhe poshtërues apo degradues ose ndëshkues të 17 dhjetorit 1984; (h) Konventën ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve të 20 dhjetorit 1989". Së fundi, neni 1.4 vuloste orientimin e ri të sistemit të drejtësisë dhe rendit të ri juridik, kur përcaktonte si vijon: "Asnjë person, i cili ushtron detyra publike apo mban ndonjë pozitë publike në Kosovë nuk lejohet të diskriminojë ndonjë person tjetër për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, bindjes politike ose bindjeve të tjera, origjinës kombëtare, etnike apo sociale, shoqërimit me një komunitet kombëtar, pasurisë, lindjes ose të ndonjë statusi tjetër. Në procedurat penale, i pandehuri përfiton nga dispozita më e favorshme e ligjit penal në fuqi që nga data 22 mars 1989 deri në ditën e nxjerrjes së kësaj rregulloreje".

Rregullorja nr. 2000/1 ka qenë vendimtare në formimin e strukturave institucionale qeverisëse, e cila në parimet e saj përcaktonte se çdo vendim administrativ dhe tjetër duhet të merren në pajtim më ligjin në fuqi në Kosovë ashtu siç ishte përcaktuar nga UNMIK-u. Këto struktura të përkohshme kishin të bënin me sferën legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe në sferën e vetëqeverisjes lokale. Në këto struktura të përbashkëta hynte edhe departamenti i drejtësisë (DD i UNMIK-ut). Njëri prej shefave të këtij departamenti ishte vendor e tjetri ndërkombëtar. Ky departament ka rikrijuar institucionet e gjyqësisë së rregullt dhe institucionin e prokurorisë: menjëherë pas themelimit, rikrijoj **GJSKos**, gjykatat e qarkut, gjykatat komunale, gjykatat komunale për kundërvajtje, dhe 13 zyra të prokurorisë publike. Menjëherë më pastaj ka krijuar edhe 6 gjykata komunale dhe një për veprat penale të të miturve. Në këto gjykata në fillim u punësuan 95 gjyqtarë dhe prokurorë, për t'u pasuar nga 124 të tjerë viteve në vijim. 230 porotë u caktuan dhe afërsisht edhe 200 të tjerë viteve në vijim. Edhe stafi mbështetës u caktua paralelisht me caktimin e gjyqtarëve, gjyqtarëve porotë dhe prokurorëve. Këto arritje në sistemin e drejtësisë gjatë kohës së UNMIK kanë qenë kryesisht të lidhura për **Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë** (OSBE). U mor vesh, në trupën gjyqësore hyjnë edhe gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtarë, të cilët në këtë fazë kanë qenë në shumicë dhe kanë vendosur lëndët, sepse vendorët kanë qenë në pakicë nëpër trupat gjykuese dhe në prokurori. Si një gjyq më vete ka qenë paneli apo gjykatat e UNMIK-ut që kanë vendosur për krimet e luftës dhe krimet etnike, ku gjithashtu vendorët nuk kanë qenë në shumicë dhe nuk kanë pasur asnjë ndikim në vendosje të rasteve. Këtë gjendje e ka përligjur dokumenti i njohur si "Korniza Kushtetuese", e cila ka pasur dispozita shumë më të përmbledhura dhe të natyrës më kushtetuese, përkundër që ka qenë për nga natyra juridike një rregullore e UNMIK-ut.

21.4. Sistemi drejtësisë pas shpalljes së pavarësisë

Pas shpalljes së pavarësisë së vendit më 17 shkurt 2008, ka nisur një jetë e re për sistemin e drejtësisë: gradualisht ka nisur zëvendësimi i strukturave normative të nxjerra nga UNMIK-u, përmes nxjerrjes së ligjeve dhe akteve të tjera të rëndësishme për kompletimin e sistemit të ri të një shteti sovran dhe të pavarur. Në këtë kuptim ka ekzistuar një periudhë tranzitore; e para ka zgjatur deri në shtator të vitit 2012, kurse tjetra deri në themelimin e **Gjykatës Speciale**: në këtë periudhë të ndërmjetme, pra nga vitit 2012 e deri te themelimi Gjykatës Speciale, të cilën e diskutojmë më poshtë, sistemi i drejtësisë në çështjet penale që kanë pasur të bëjnë me krimet e korrupsionit dhe krimit të organizuar, krimet e luftës, kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare janë trajtuar nga misioni i posaçëm evropian, i njohur si misioni **EULEX**.

Në **KKos**, sistemi i drejtësisë normohet me **kapitullin VII** (nenet 102-111) të **KKos**. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovë ushtrohet nga gjykatat (neni 102.1 i KKos). Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata (neni 102.2 i KKos). Gjykatat gjykojnë në bazë të KKos dhe ligjit (neni 102.3 i KKos). Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm (neni 102.4 i KKos). Garantohet e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe. E drejta e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, rregullohet me ligj. Me ligj mund të lejohet e drejta për të referuar një rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në GJSKos, dhe për të tilla raste nuk ka të drejtë ankese (neni 102.5 i KKos).
Organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i Gjykatës Supreme dhe i gjykatave të tjera, rregullohen me ligj (neni 103.1 i **KKos**). Aktualisht ekziston Ligji për Gjykatat, Ligji nr. 06/L-054, i cili përpunon dispozitat kushtetuese mbi sistemin gjyqësor në Kosovë. Gjykata Supreme e Kosovës është autoriteti më i lartë gjyqësor (neni 103.2 i **KKos**). Të paktën 15% e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, por jo më pak se tre (3) gjyqtarë, do të jenë nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë (neni 103.3 i **KKos**). Kryetarin e **GJKRKS** e emëron dhe shkarkon presidenti i Kosovës, nga radhët e gjyqtarëve të **GJSKos**, për mandat shtatëvjeçar, pa mundësi të riemërimit, pas propozimit të **KGJK-së** për emërimin ose shkarkimin e saj/tij (neni 102.4 i **KKos**). Kryetarët e të gjitha gjykatave të tjera emërohen në mënyrën e përcaktuar me ligj (neni 102.5 i **KKos**). Të paktën 15% e gjyqtarëve nga cilado gjykatë tjetër, e themeluar me juridiksionin e apelit, por jo më pak se dy (2) gjyqtarë do të jenë nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë (neni 103. 6 i KKos). Gjykata të specializuara mund të themelohen me ligj kur kjo të jetë e nevojshme, por në asnjë mënyrë nuk mund të themelohen **gjykata të jashtëzakonshme** (neni 103.7 i **KKos**).

Gjyqtarët i emëron, riemëron dhe shkarkon Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (neni 104.1 i **KKos**). Përbërja e gjyqësorit pasqyron shumëllojshmërinë etnike të Kosovës dhe parimet e pranuara ndërkombëtarisht të barazisë gjinore (neni 104.2 i **KKos**). Përbërja e gjykatave pasqyron përbërjen etnike të juridiksionit territorial të gjykatës përkatëse. Para dhënies së propozimit për emërim ose riemërim, **KGJK** këshillohet me gjykatën përkatëse (neni 104.3 i **KKos**). Gjyqtarët mund të shkarkohen nga funksioni për shkak të dënimit për një vepër të rëndë penale ose për mosrespektimin e rëndë të detyrave (neni 104.4 i **KKos**). Gjyqtarët kanë të drejtë të ankohen ndaj vendimit mbi shkarkimin drejtpërdrejt në **GJSKos** (neni 104.5 i **KKos**). Gjyqtarët nuk mund të transferohen kundër vullnetit të tyre, përveç nëse është parashikuar ndryshe me ligj, për shkak të funksionimit efikas të gjyqësorit ose masave disiplinore (neni 104.6 i **KKos**).

Mandati fillestar për gjyqtarët është trevjeçar. Në raste të riemërimit, mandati është i përhershëm deri në moshën e pensionimit, sikurse është përcaktuar më ligj, përveç nëse shkarkohet në pajtim me ligjin (neni 105.1 i **KKos**). Kriteret dhe procedurat për riemërimin e një gjyqtari, përcaktohen nga **KGJK** dhe ato mund të dallojnë në shkallë nga kriteret e përdorura për shkarkimin e gjyqtarëve (neni 105.2 i **KKos**). Gjyqtari nuk mund të ushtrojë ndonjë funksion në institucionet shtetërore jashtë gjyqësorit,

të jetë i përfshirë në ndonjë aktivitet politik ose ndonjë aktivitet tjetër të ndaluar me ligj (neni 106.1 i KKos). Gjyqtarëve nuk u lejohet të marrin përgjegjësi ose të jenë bartës të funksioneve, të cilat në çfarëdo mënyre, do të ishin në kundërshtim me parimet e pavarësisë dhe paanësisë së rolit të gjyqtarit (neni 106.2 i KKos).

Gjyqtarët, përfshirë edhe gjyqtarët porotë, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre si gjyqtarë (neni 107.1 i **KKos**). Gjyqtarët, përfshirë edhe gjyqtarët porotë, nuk gëzojnë imunitet dhe mund të shkarkohen nga funksioni, kur të kenë shkelur ligjin me qëllim (neni 107.2 i **KKos**). Kur një gjyqtar akuzohet ose arrestohet, duhet të njoftohet pa vonesë KGJK-ja (neni 107.3 i **KKos**).

KGJK-ja siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor (neni 108.1 i KKos) dhe është institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij. Ai siguron që gjykatat në Kosovë të jenë të pavarura, profesionale e të paanshme, dhe të pasqyrojnë plotësisht natyrën shumetnike të Republikës së Kosovës e të ndjekin parimet e barazisë gjinore. Këshilli duhet t'u japë përparësi për emërim si gjyqtarë, anëtarëve të komuniteteve të nënpërfaqësuara në mënyrën e përcaktuar me ligj (neni 108.2 i KKos). KGJK-ja është përgjegjëse për rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërim dhe riemërim për pozita gjyqësore. Ai është po ashtu përgjegjës për transferimin dhe për procedurën disiplinore kundër gjyqtarëve (neni 108.3 i KKos). Propozimet për emërimin e gjyqtarëve duhet të bëhen në bazë të procesit të hapur për emërime, në bazë të meritave të kandidatëve, dhe ky propozim pasqyron parimin e barazisë gjinore dhe përbërjen etnike të juridiksionit territorial të gjykatës përkatëse. Të gjithë kandidatët duhet t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj (neni 108.4 i **KKos**). **KGJK** është përgjegjës për inspektimin gjyqësor, administrimin gjyqësor, përpilimin e rregullave për gjykatat në pajtim me ligjin, punësimin dhe mbikëqyrjen e administratorëve të gjykatave, hartimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit për gjyqësorin, përcaktimin e numrit të gjyqtarëve në secilin juridiksion dhe bën rekomandime për themelimin e gjykatave të reja. Themelimi i gjykatave të reja bëhet me ligj (neni 108.5 i **KKos**). Këshilli përbëhet nga trembëdhjetë (13) anëtarë, me kualifikime dhe ekspertizë profesionale. Anëtarët emërohen për një mandat pesëvjeçar dhe zgjidhën në këtë mënyrë: (1) Pesë (5) anëtarë do të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga anëtarët e gjyqësorit; (2) Katër (4) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve. Të paktën dy (2) nga katër (4) anëtarët duhet të jenë gjyqtarë, dhe një (1) do të jetë anëtar i **Odës së Avokatëve të Kosovës** (OAK); (3) Dy (2) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komunitetit serb në Kosovë, dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtar; (4) Dy (2) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve të tjera, dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtar; (5) Papajtueshmëria e të qenit anëtar i KGJK-së rregullohet me ligj (neni 108.6 i **KKos**). Kjo përbërje e KGJK-së ka ndryshuar më pastaj: me amendamentin nr. 25, miratuar me vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 05-V-229, datë 24 shkurt 2016, neni 108, paragrafi 6, nënparagrafi 1 dhe 2 i **KKos** si më sipër janë ndryshuar, ashtu që aktualisht ato dispozita kushtetuese përcaktojnë si në vijim: "(1) Shtatë (7) anëtarë do të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga anëtarët e gjyqësorit. (2) Dy (2) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtar".

KGJK-ja, nga radhët e anëtarëve të vet, zgjedh kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin me mandat trevjeçar. Zgjedhja në këto funksione nuk e zgjat mandatin e anëtarit të KGJK-së (neni 108.7 i **KKos**). Kryesuesi i **KGJK**-së i drejtohet Kuvendit të Republikës së Kosovës së paku një herë në vit lidhur me sistemin gjyqësor (neni 108.8). Kandidatët për pozita gjyqësore, të cilat janë të rezervuara për pjesëtarët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë, mund të rekomandohen për emërim vetëm nga anëtarët e **KGJK**-së të zgjedhur nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për pjesëtarët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë. Nëse ky grup i anëtarëve

të këshillit nuk e propozon kandidatin për këtë pozitë gjyqësore pas dy seancave të njëpasnjëshme të këshillit, atëherë cilido anëtar i këshillit ka të drejtë ta rekomandojë kandidatin për atë pozitë gjyqësore (neni 108.9 i **KKos**). Kandidatët për pozita gjyqësore të gjykatave themelore, nën juridiksionin e të cilave përfshihet ekskluzivisht territori i një a më shumë komunave, ku shumica e popullsisë i takon komunitetit serb të Kosovës, mund të rekomandohen për emërim vetëm nga dy (2) anëtarët e KGJK-së që i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për komunitetin serb në Republikën e Kosovës të cilët veprojnë bashkërisht dhe në mënyrë unanime. Nëse këta dy (2) anëtarë nuk rekomandojnë kandidat gjyqësor për këtë pozitë, gjatë dy seancave të njëpasnjëshme të **KGJK**-së, atëherë cilido anëtar i **KGJK**-së ka të drejtë të propozojë kandidat për atë pozitë (neni 108.10 i **KKos**).

Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë vepër penale ose për ndonjë vepër tjetër, sikurse është rregulluar me ligj (neni 109.1 i **KKos**). Prokurori i Shtetit është institucion i paanshëm dhe vepron në bazë të kushtetutës dhe të ligjit (neni 109.2 i **KKos**). Organizimi, kompetencat dhe detyrat e Prokurorit të Shtetit rregullohen me ligj (neni 109. 3 i **KKos**). Ligji për Prokurorin e Shtetit, Ligji nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, më tutje operacionalizon këtë dispozitë kushtetuese. Prokurori i Shtetit pasqyron përbërjen shumetnike të Republikës së Kosovës dhe respekton parimet e barazisë gjinore (neni 109.4 i **KKos**). Mandati fillestar për prokuror është trevjeçar. Në rast të riemërimit, mandati është i përhershëm deri në moshën e pensionimit, sikurse është përcaktuar me ligj, përveç nëse shkarkohet në pajtim me ligjin (neni 109.5 i **KKos**). Prokurorët mund të shkarkohen nga funksioni për shkak të dënimit për një vepër të rëndë penale ose për mosrespektimin e rëndë të detyrave (neni 109.6 i **KKos**). Kryeprokurori i Shtetit emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të propozimit të KPK-së, për një mandat shtatëvjeçar, pa mundësi riemërimi (neni 109.7 i **KKos**).

KPK është institucion plotësisht i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij, në pajtim me ligjin. Këshilli Prokurorial i Kosovës siguron qasje të barabartë në drejtësi për të gjithë personat në Kosovë. **KPK-ja** siguron që Prokurori i Shtetit të jetë i pavarur, profesional, i paanshëm dhe pasqyron natyrën shumetnike të Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore (neni 110.1 i **KKos**). Këshilli rekruton, propozon, avancon, transferon, disiplinon prokurorët në mënyrën e rregulluar me ligj. Ai i jep përparësi emërimit për prokurorë të anëtarë të komuniteteve të nënpërfaqësuar në mënyrën e përcaktuar me ligj. Të gjithë kandidatët duhet t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj (neni 110.2 i **KKos**). Propozimet për emërimin e prokurorëve duhet të bëhen në bazë të procesit të hapur për emërime, në bazë të meritave të kandidatëve, dhe ky propozim pasqyron parimin e barazisë gjinore dhe përbërjen etnike të juridiksionit territorial përkatës (neni 110.3 i **KKos**). Përbërja e **KPK-së**, si dhe dispozitat për emërimin, shkarkimin, mandatin, strukturën organizative dhe rregullat e procedurës, rregullohen me ligj (neni 110.5 i **KKos**).

Avokatura është profesion i pavarur, i cili ofron shërbime sikur është e rregulluar me ligj (neni 111.1 i **KKos**). Mënyra e fitimit të së drejtës për të ushtruar profesionin e avokatit, si dhe marrja e kësaj të drejte, rregullohen me ligj (neni 111.2 i **KKos**). Me këtë nen, kushtetutëbërësi kosovar ia ka dhënë avokatisë fuqinë e një organi me rëndësi kushtetuese në kuadër të sistemit të drejtësisë.

Me nxjerrjen amendamentit kushtetues të datës 3 gusht 2015, përkatësisht me nxjerrjen e amendamentit nr. **24** në **KKos** (tani neni 162 i saj),[218] u krijua baza e re kushtetuese për bartjen e tërësishme jashtë Kosovës të juridiksionit të saj gjyqësor, përfshirë juridiksionin në çështjet kushtetuese. Juridiksionet në fjalë, ai i gjyqësorit të rregullt dhe ai kushtetues, u bartën në të a.q. **Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar, në diskursin publik të njohura si Gjykata Speciale** me

[218] **AMENDAMENTIMI I KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, NR. 05 - V – 139 I DATËS 3 GUSHT 2013**. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* /Nr. 20/05 gusht 2015, PRISHTINË.

seli në Hagë. Pas kontrollit të kushtetutëshmërisë së këtij amendamenti, të kryer nga **GJKRKS** me aktgjykimin e saj në rastin KO 26/15 të datës 15 prill 2015,[219] dhe hyrjes së tij në fuqi, ka pasuar nxjerrja e legjislacionit implementues, vendor[220] dhe ndërkombëtar,[221] me qëllim të operacionalizimit të **Gjykatës Speciale.** Legjislacioni për krijimin e saj, përfshirë amendamentin kushtetues nr. **24**, janë draftuar në **Bruksel**.[222] **Gjykata Speciale** është themeluar si përgjigje ndaj një akuze ndërkombëtare të bërë nga një prokuror zviceran, i njohur si raporti **Dik Marti** (Dick Marty), raport që është përkrahur me një dokument të **Asamblesë Parlamentare (AP) të KE-së,** dokumenti nr. 12462 i datës 7 janar 2011. Këtë dokument më pastaj **Kosova** e ka kthyer në një detyrim ndërkombëtar që duhet të zbatohet përmes ratifikimit të tij në **Kuvendin e Kosovës** më datën 23 prill 2014.[223]

22. Sistemi drejtësisë në Shqipëri

Pjesa e nëntë (135-147) e **KShq** normon gjykatat dhe pushtetin gjyqësor, kurse pjesa e dhjetë (nenet 148-149) rregullon organin e akuzës. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj (neni 135.1 i **KShq**). **Gjykatat e posaçme** gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, kryetarit të Kuvendit, kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të **GJKSH-së** dhe të Gjykatës së Lartë (GJLSH), Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD), kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur (neni 135.2 i **KShq**). Kuvendi mund të krijojë me ligj gjykata të tjera për fusha të veçanta, por në asnjë rast gjykata të jashtëzakonshme (neni 135.3 i **KShq**). Gjyqtarët e gjykatave të posaçme që parashikohen në paragrafin 2, të këtij neni, emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), sipas ligjit. Gjyqtarët e gjykatave të posaçme shkarkohen nga detyra me dy të tretat e anëtarëve të **KLGJ-së**. Kandidatët për gjyqtarë dhe nëpunës civilë gjyqësorë në gjykatat e posaçme, si dhe familjarët e afërm të kandidatëve, para emërimit, i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe të figurës, si dhe japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit i (neni 135.4 i **KShq**).

Gjyqtarët e **GJLSH-së** emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të KLGJ-së, për një mandat 9-vjeçar, pa të drejtë riemërimi (neni 136.1 i **KShq**). Presidenti i Republikës, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së vendimit të KLGJ-së, emëron gjyqtarin e **GJLSH**-së, me përjashtim të rasteve kur presidenti konstaton se kandidati nuk plotëson kriteret e kualifikimit ose kushtet e zgjedhshmërisë, sipas ligjit. Dekreti i Presidentit të Republikës për mosemërimin e kandidatit humb fuqinë kur kundër tij votojnë shumica e anëtarëve të KLGJ-së. Në këtë rast, si dhe kur presidenti nuk shprehet, kandidati shpallet i emëruar dhe fillon detyrën brenda 15 ditëve nga data e vendimit të KLGJ-së (neni 136.2 i **KShq**). Gjyqtari i **GJLSH**-së zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur, me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose ligjërues të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në admin-

219 *AKTGJYKIM në rastin nr. KO 26/15. Vleresim i amendamentit të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe referuar më 9 mars 2015 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, me shkresën nr. 05-433 /DO-318***.** Prishtinë, më 15 prill 2015. Nr. ref.: AGJ 788/15.

220 **Ligji Nr. 05/L-053 PËR DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRËN E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR.** Prishtinë 3 gusht 2015**; DEKRET PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE.** NR. DMN - 003 – 2016. Prishtinë 3 shkurt 2016**.**

221 **Interim Agreement between the Kingdom of the Netherlands and the Republic of Kosovo concerning the Hosting of the Kosovo Relocated Specialist Judicial Institution in the Netherlands**. Pristina, 26 January 2016.

222 Cf. më shumë në Enver Hasani and Getoar Mjeku, "International(ized) Constitutional Court: Kosovo's Transfer of Judicial Sovereignty" *Vienna Journal on International Constitutional Law* Vol. 13, Issue 4 (December 2019), fq. 373–402.

223 **LIGJI NR. 04/L -274 PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE NË MES TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE BASHKIMIT EVROPIAN MBI MISIONIN E BASHKIMIT EVROPIAN PËR SUNDIM TË LIGJIT NË KOSOVË.** *Gazeta Zyrtare e Republkikës së Kosovës* nr. 32/14. Datë 15 maj 2014.

istratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. Kandidatët që përzgjidhen nga radhët e juristëve duhet të kenë gradë shkencore në drejtësi (neni 136.3 i **KShq**). Kandidati jogjyqtar nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit. Kritere të tjera dhe procedura e përzgjedhjes së gjyqtarit parashikohen me ligj (neni 136.4 i **KShq**). Gjyqtari i GJLSH-së qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, përveç rasteve të parashikuara në nenin 139, paragrafi 3, nënparagrafët ”c”, “ç”, “d” dhe ”dh”. Gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga KLGJ-ja, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit (neni 136/a., Para.1 i **KShq**). Kritere të tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligj (neni neni 136/a., para.2 i **KShq)**.

Gjyqtari gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrimin e funksioneve të tij, përveç rasteve të dhënies qëllimisht të një vendimi, si pasojë e një interesi vetjak ose keqbesimi (neni 137 i **KShq**). Paga dhe përfitimet e tjera të gjyqtarit nuk mund të ulen, përveç rasteve kur: a) nevojitet marrja e masave të përgjithshme ekonomiko-financiare për të shmangur situata të vështira financiare të vendit ose emergjenca të tjera kombëtare; b) gjyqtari kthehet në detyrën që mbante para emërimit; c) i jepet një masë disiplinore ose vlerësohet i pamjaftueshëm profesionalisht, sipas ligjit (neni 138 i **KShq**).

Mandati i gjyqtarit të **GJLSH-së** mbaron në rastet e mëposhtme: a) mbush moshën e pensionit; b) përfundon mandatin 9-vjeçar; c) jep dorëheqje; ç) shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 140 të Kushtetutës; d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit; dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën (neni 139.1 i **KShq**). Mbarimi i mandatit të gjyqtarit të GJLSH-së deklarohet me vendim të Gjykatës së Lartë (neni 139.2 i **KShq**). Procedura për emërimin e gjyqtarit në një gjykatë tjetër pas përfundimit të mandatit rregullohet me ligj (neni 139.3 i **KShq**).

Gjyqtari mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit (neni 140.1 i **KShq**). Gjyqtari shkarkohet nga KLGJ-ja kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës; b) është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi (neni 140.2 i **KShq**). Gjyqtari pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor kur: a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal ”arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale; b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje; c) kur fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit (neni 140.3 i **KShq**). Kundër vendimit të shkarkimit mund të bëhet ankim në **GJKSH** (neni 140.4 i **KShq**).

GJLSH-ja shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit (neni 141.1 i **KShq**). Për ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë tërheq për shqyrtim në kolegjet e bashkuara çështje të caktuara gjyqësore të vendosura nga kolegjet, sipas ligjit (neni 141.2 i **KShq**). Vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara (neni 142.1 i **KShq**). **GJLSH** duhet t’i botojë vendimet e saj, si dhe mendimet e pakicës (neni 142.2 i **KShq**). Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore (neni 142.3 i **KShq**).

Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik, shkencor, si dhe delegimit pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë, sipas ligjit (neni 143 i **KShq**). Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm **KShq** dhe ligjeve (Neni 145.1 i **KShq**). Kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me **KShq**, nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen **GJKSH**-së. Vendimet e GJKSH-së janë të detyrueshme për të gjitha gjykatat (neni 145.2 i **KShq**). Ndërhyrja në veprimtarinë e gjykatave ose të gjyqtarëve passjell përgjegjësi sipas ligjit (neni 145.3 i **KShq**). Gjykatat i japin vendimet në emër të Republikës (neni 146.1 i **KShq**).Vendimet gjyqësore shpallen publikisht në çdo rast (neni 146.2 i **KShq**).

KLGJ-ja siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë (neni 147.1 i **KShq**). Ai përbëhet nga 11 anëtarë, gjashtë prej të cilëve zgjidhen nga gjyqtarët e të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor dhe pesë anëtarë i zgjedh Kuvendi, nga radhët e juristëve jogjyqtarë (neni 147.2 i i **KShq**). Anëtarët gjyqtarë përzgjidhen nga radhët e gjyqtarëve me integritet të lartë moral dhe profesional, sipas një procedure transparente dhe publike që siguron një përfaqësim të drejtë të të gjitha niveleve të gjyqësorit. Anëtarët jogjyqtarë përzgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ata nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera dhe procedura për përzgjedhjen e kandidatëve rregullohen me ligj (neni 147.3 i **KShq**). Dy anëtarë jogjyqtarë zgjidhen nga radhët e avokatëve, dy anëtarë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, si dhe një anëtar nga shoqëria civile. Sekretari i përgjithshëm i Kuvendit, bazuar në një procedurë transparente dhe publike, shpall vendet vakante, sipas ligjit (neni 147.4 i **KShq**). Sekretari i përgjithshëm i Kuvendit, jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e kandidaturave, verifikon nëse kandidatët plotësojnë kushtet e parashikuara nga kushtetuta dhe ligji, si dhe vlerëson kriteret profesionale e morale për anëtarin e KLGJ-së dhe përgatit listën. Në rast se kandidatët nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret për t'u zgjedhur, Sekretari i përgjithshëm i Kuvendit nuk i përfshin emrat e tyre në listë (neni 147.5 i **KShq**). Sekretari i përgjithshëm i Kuvendit pas përfundimit të verifikimeve, ia dërgon menjëherë listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret formale nënkomisionit, sipas paragrafit 7 të këtij neni (neni 147.6 i **KShq**). Komisioni i përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend krijon një nënkomision për vlerësimin e mëtejshëm dhe përzgjedhjen e kandidatëve jo më vonë se 3 ditë nga paraqitja e listës. Nënkomisioni përbëhet nga 5 deputetë, prej të cilëve 3 caktohen nga shumica dhe 2 nga pakica parlamentare. Nënkomisioni, me të paktën katër vota, mund të përfshijë në listën e kandidatëve edhe ata që janë përjashtuar nga Kuvendi për mospërmbushje të kritereve formale. Nënkomisioni përzgjedh kandidatët me mbështetjen e të paktën 4 anëtarëve. Nëse nuk arrihet shumica e kërkuar, kandidatët përzgjidhen me short (neni 147.7 i **KShq**). Emrat e kandidatëve të përzgjedhur nga nënkomisioni përmblidhen në një listë dhe i dërgohen kryetarit të Kuvendit. Brenda 10 ditëve, Kuvendi miraton listën e kandidatëve me 2/3 e të gjithë anëtarëve. Nëse lista rrëzohet, procedura përsëritet në nënkomision sipas pikës 7 të këtij neni, por jo më shumë se dy herë. Në rast se pas zhvillimit për herë të tretë të procedurës Kuvendi nuk miraton listën e paraqitur, kandidatët e kësaj liste konsiderohen të zgjedhur. Procedura e detajuar rregullohet me ligj (neni 147.8 i **KShq**). Kryetari i KLGJ zgjidhet në mbledhjen e parë të Këshillit nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë, sipas ligjit (neni 147.9 i **KShq**). Anëtarët e KLGJ-së e ushtrojnë detyrën me kohë të plotë për një periudhë prej pesë vjetësh, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme. Në përfundim të mandatit, anëtarët gjyqtarë kthehen në vendet e mëparshme të punës. Gjyqtarit të **GJLSH-së** ose të gjykatës së posaçme i pezullohet mandati si gjyqtar gjatë kohës që ushtron funksionin si anëtar i **KLGJ-së**. Anëtarët jogjyqtarë që përpara emërimit punonin me kohë të plotë në sektorin publik, rikthehen në vendet e mëparshme të punës ose në pamundësi, në detyra të barasvlershme me to (neni 147.10 i **KShq**).

KLGJ-ja ushtron funksionet si vijon: a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve; b) vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve; c) i propozon Presidentit të Republikës kandidatët për gjyqtarë të **GJLSH-së**, sipas ligjit; ç) miraton rregullat e etikës gjyqësore dhe mbikëqyr respektimin e tyre; d) drejton dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, me përjashtim të mbarëvajtjes së strukturave të teknologjisë së informacionit në gjykata, e cila rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave; dh) propozon dhe administron buxhetin e tij dhe të gjykatave; e) informon publikun dhe Kuvendin për gjendjen e sistemit gjyqësor; ë) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj (neni 147/a., parag. 1 i **KShq**). Ligji mund të parashikojë krijimin e komisioneve vendimmarrëse pranë **KLGJ-së** (neni 147/a., parag. 2 i **KShq**). 3. Ministri i Drejtësisë mund të marrë pjesë, pa të drejtë vote, në mbledhjet e KLGJ-së kur diskutohen çështje që lidhen me planifikimin strategjik dhe buxhetin e pushtetit gjyqësor (neni 147/a., parag. 3 i **KShq**).

Mandati i anëtarit të **KLGJ-së** mbaron sipas rasteve si vijon: a) mbush moshën e pensionit; b) përfundon mandatin 5-vjeçar; c) jep dorëheqje; ç) shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 147/c të kushtetutës; d)

vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit; dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën (neni 147/b., parag. 2 i **KShq**). Mbarimi i mandatit të anëtarit deklarohet me vendim të KLGJ-së (neni 147/b., parag. 2 i **KShq**). Kur vendi i anëtarit mbetet vakant, organi që ka emëruar anëtarin paraardhës, sipas nenit 147, emëron një anëtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të anëtarit të larguar (neni 147/b., parag. 3 i **KShq**). Anëtari i KLGJ-së qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, përveç rasteve të parashikuara në nënparagrafët ”c”, “ç”, “d” dhe ”dh”, të paragrafit 1, të këtij neni (neni 147/b., parag. 4 i **KShq**).

Anëtari i **KLGJ-së** mban **përgjegjësi disiplinore**, sipas ligjit (neni 147/c., parag. 1 i **KShq**). Ai shkarkohet nga GJKSH-ja kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike; b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi (neni 147/c., parag. 2 i **KShq**). Anëtari i KLGJ-së **pezullohet nga detyra** me vendim të GJKSH-së kur: a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal ”arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale; b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje; c) fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit (neni 147/c., parag/ 3 i **KShq**). Qenia anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të veprimtarisë mësimdhënëse, akademike dhe shkencore, sipas ligjit (neni 147/ç i **KShq**).

ILD-ja është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të **KLGJ-së**, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP-së) dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj (neni 147/d., parag. 1 **KShq**). ILD-ja është përgjegjës edhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë (neni 147/d., 2 **KShq**). **ILD-ja** zgjidhet me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, për një periudhë 9-vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje, nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ai nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit (neni 147/d., parag.3 **KShq**). ILD-ja zgjidhet nga lista e pesë kandidatëve të përzgjedhur dhe renditur mbi bazën e meritave nga **Këshilli i Emërimeve në Drejtësi**, sipas një procedure transparente dhe publike. Në rast se Kuvendi nuk arrin shumicën prej tri të pestave për asnjë prej kandidatëve brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës, kandidati i renditur i pari shpallet i emëruar (neni 147/d., parag. 4 **KShq**). ILD gëzon statusin e gjyqtarit të GJLSH-së (neni 147/d., parag. 5 **KShq**). Procedura e vendimmarrjes nga ILD-ja rregullohet me ligj. Ankimet ndaj vendimeve lidhur me masat disiplinore ndaj inspektorëve të tjerë shqyrtohen nga GGJKSH-ja (neni 147/d., parag. 6 **KShq**). **Mandati** i ILD-së mbaron kur: a) mbush moshën e pensionit; b) përfundon mandatin 9-vjeçar; c) jep dorëheqje; ç) shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 147/e të kushtetutës; d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit; dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën (neni 147/dh., parag. 1 **KShq**). Mbarimi i mandatit të ILD-së deklarohet me vendim të mbledhjes së përbashkët të KLGJ-së dhe të KLP-së (neni 147/dh., parag. 2 **KShq**). ILD-ja qëndron në detyrë deri në emërimin e inspektorit të ri, me përjashtim të rasteve të parashikuara në paragrafin 1, nënparagrafët ”c”, “ç”, “d” dhe ”dh” (neni 147/dh., parag. 3 **KShq**). Pas përfundimit të mandatit, me kërkesë të tij, ILD-ja kthehet në detyrën që mbante para emërimit ose në një detyrë të përafërt me të (neni 147/dh., parag. 4 **KShq**).

ILD-ja mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit (neni 147/e., parag. 1 **KShq**). Ai shkarkohet nga GJKSH-ja kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike; b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi (neni 147/e., parag. 2 **KShq**). Pretendimet lidhur me shkeljet disiplinore të ILD-së hetohen nga një komision hetimor i Kuvendit, duke respektuar të drejtën e tij për proces të rregullt. Komisioni hetimor, në rast se konstaton shkelje sipas paragrafit, 2 të këtij neni, i propozon GJKSH-së shkarkimin e ILD-së, sipas ligjit (neni 147/e., parag.3 **KShq**). ILD-ja pezullohet nga detyra me vendim të GJKSH-së kushtetuese kur: a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal ”arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale; b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje; c) fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit (neni 147/e., parag. 4 **KShq**). Në fund, KShq sanksionon **konflik-**

tin e interesit të ILD-së: qenia ILD nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik ose shkencor, sipas ligjit (neni 147/ë i **KShq**).

Pjesa e dhjetë e KSHq i kushtohet Prokurorisë. Ajo definohet si organ që ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj (neni 148.1 i **KShq**). Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit (neni 148.2 i **KShq**). Prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor (neni 148.3 i **KShq**). **Prokuroria e Posaçme** dhe **Njësia e Posaçme Hetimore** për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi 2, të KShq janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm. Njësia e Posaçme Hetimore është në varësi të Prokurorisë së Posaçme (neni 148.4 **i KShq**). Prokurori i Përgjithshëm zgjidhet me tri të pestat e anëtarëve të Kuvendit, mes tre kandidatëve të propozuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, për një mandat 7-vjeçar dhe pa të drejtë riemërimi (neni 148/a., parag. 1 i **KShq**). KLD-ja, bazuar në një thirrje publike dhe procedurë transparente, përzgjedh dhe rendit tre kandidatët më të kualifikuar dhe ia përcjell Kuvendit, sipas ligjit (neni 148/a., parag. 2 i **KShq**). Prokurori i Përgjithshëm zgjidhet nga radhët e juristëve të spikatur, me jo më pak se 15 vjet përvojë pune, me integritet të lartë moral dhe profesional, që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës ose kanë një gradë shkencore në drejtësi. Kandidati nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit (neni 148/a., parag. 3 i **KShq**). Nëse Kuvendi nuk zgjedh Prokurorin e Përgjithshëm brenda 30 ditëve nga paraqitja e propozimeve, kandidati i renditur i pari nga **KLD-ja** shpallet i emëruar (neni 148/a., parag. 4 i **KShq**). Pas përfundimit të mandatit dhe me kërkesë të tij, Prokurori i Përgjithshëm emërohet në detyrën e mëparshme ose gjyqtar në gjykatën e apelit (neni 148/a., parag. 5 i **KShq**).

Prokurori i Përgjithshëm ushtron këto kompetenca: a) përfaqëson akuzën në **GJLSH** dhe çështjet në GJKSH, me përjashtim të rastit kur përfaqësimi bëhet nga Prokuroria e Posaçme; b) nxjerr udhëzime të përgjithshme me shkrim për prokurorët, me përjashtim të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme; c) siguron mbarëvajtjen e punës në administratën e prokurorisë, me përjashtim të administratës së Prokurorisë së Posaçme. Krijimi dhe mbarëvajtja e strukturave të teknologjisë së informacionit në prokurori rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave; ç) propozon dhe administron buxhetin e prokurorisë, me përjashtim të buxhetit të Prokurorisë së Posaçme; d) raporton në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit; dh) ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara në ligj (neni 148/b i i **KShq**). Mandati i Prokurorit të Përgjithshëm mbaron kur: a) mbush moshën e pensionit; b) përfundon mandatin 7-vjeçar; c) jep dorëheqje; ç) shkarkohet sipas nenit 149/c të KShq; d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit; dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën (neni 148/c., parag.1 i **KShq**). Mbarimi i mandatit deklarohet me vendim të KLP-së (neni 148/c., parag.2 i **KShq**). Prokurorë mund të jenë shtetasit shqiptarë, që emërohen nga KLP-ja pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit (neni 148/ç., parag.1 i **KShq**). Kriteret e tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e prokurorëve parashikohen me ligj (neni 148/ç., parag. 2 i **KShq**).

Prokurori mban **përgjegjësi disiplinore**, sipas ligjit (neni 148/d., parag. 1 **KShq**). Prokurori shkarkohet nga KLD-ja kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës; b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi (neni 148/d., parag. 2 **KShq**). Kundër vendimit të shkarkimit bëhet ankim në GJKSH (neni 148/d., parag. 3 i **KShq**). Prokurori pezullohet nga detyra me vendim të KLP kur: a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal ”arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale; b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje; c) fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit (neni 148/d., parag. 4 **KShq**).

Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën para gjykatave të posaçme të parashikuara në nenin 135, pika 2, të KShq, si dhe para GJLSH-së (neni 148/dh., parag. 1 **KShq**). Prokuroria e Posaçme përbëhet nga të paktën 10 prokurorë, të cilët emërohen nga KLP-ja për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi. Ligji vendos kritere të tjera për përzgjedhjen si dhe për procedurën transparente dhe publike të emërimit (neni 148/dh., parag. 2 **KShq**). Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme zgjidhet nga radhët e prokurorëve të kësaj prokurorie me shumicën e anëtarëve të KLP-së, për 3 vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje, sipas ligjit (neni 148/dh., parag. 3 **KShq**). Prokurori i Prokurorisë së Posaçme shkarkohet për kryerjen e një krimi ose për kryerjen e një shkeljeje të rëndë disiplinore me dy të tretat e anëtarëve të KLP-së (neni 148/dh., parag. 4 **KShq**). Kandidati për prokuror, oficer i hetimit, personel administrativ i Prokurorisë së Posaçme, Njësisë së Posaçme Hetimore, si dhe familjarët e afërm të tij, para emërimit, i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe të figurës, japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve personale, sipas ligjit (neni 148/dh., parag. 5 **KShq**).

KLP-ja garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë (neni 149.1 **KShq**). KLP-ja përbëhet nga 11 anëtarë, gjashtë prej të cilëve zgjidhen nga prokurorët e të gjitha niveleve të prokurorisë dhe pesë anëtarë zgjidhen nga Kuvendi, nga radhët e juristëve joprokurorë (neni 149.2 **KShq**). Anëtarët prokurorë përzgjidhen nga radhët e prokurorëve me integritet të lartë moral dhe profesional, sipas një procedure transparente dhe publike që siguron një përfaqësim të drejtë të të gjitha niveleve të prokurorisë. Anëtarët joprokurorë përzgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ata nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera dhe procedura për përzgjedhjen e kandidatëve rregullohen me ligj (neni 149.3 **KShq**). Dy anëtarë joprokurorë zgjidhen nga radhët e avokatëve, dy anëtarë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, si dhe një anëtar nga shoqëria civile. Sekretari i përgjithshëm i Kuvendit, bazuar në një procedurë transparente dhe publike, shpall vendet vakante, sipas ligjit (neni 149. 4 **KShq**). Sekretari i përgjithshëm i Kuvendit, jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e kandidaturave, verifikon nëse kandidatët plotësojnë kushtet e parashikuara nga kushtetuta dhe ligji, si dhe vlerëson kriteret profesionale e morale për anëtarin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe përgatit listën. Në rast se kandidatët nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret për t'u zgjedhur, sekretari i përgjithshëm i Kuvendit nuk i përfshin emrat e tyre në listë (neni 149.5 **KShq**). Sekretari i përgjithshëm i Kuvendit pas përfundimit të verifikimeve, i dërgon menjëherë listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret formale nënkomisionit, sipas paragrafit 7 të këtij neni 149.6 **KShq**). Komisioni i përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend krijon një nënkomision për vlerësimin e mëtejshëm dhe përzgjedhjen e kandidatëve jo më vonë se 3 ditë nga paraqitja e listës. Nënkomisioni përbëhet nga 5 deputetë, prej të cilëve 3 caktohen nga shumica dhe 2 nga pakica parlamentare. Nënkomisioni, me të paktën katër vota, mund të përfshijë në listën e kandidatëve edhe ata që janë përjashtuar nga sekretari i përgjithshëm i Kuvendit për mospërmbushje të kritereve formale. Nënkomisioni përzgjedh kandidatët me mbështetjen e të paktën 4 anëtarëve. Nëse nuk arrihet shumica e kërkuar, kandidatët përzgjidhen me short (neni 149.7 **KShq**). Emrat e kandidatëve të përzgjedhur nga nënkomisioni përmblidhen në një listë dhe i dërgohen Kryetarit të Kuvendit. Brenda 10 ditëve, Kuvendi miraton listën e kandidatëve me 2/3 e të gjithë anëtarëve. Nëse lista rrëzohet, procedura përsëritet në nënkomision sipas pikës 7 të këtij neni, por jo më shumë se dy herë. Në rast se pas zhvillimit për herë të tretë të procedurës Kuvendi nuk miraton listën e paraqitur, kandidatët e kësaj liste konsiderohen të zgjedhur. Procedura e detajuar rregullohet me ligj (neni 149.8 **KShq**). Kryetari i KLP-së zgjidhet në mbledhjen e parë të Këshillit nga radhët e anëtarëve joprokurorë, sipas ligjit (neni 149.9 **KShq**). Anëtarët e KLP-së e ushtrojnë detyrën me kohë të plotë për një periudhë prej pesë vjetësh, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme. Në përfundim të mandatit, anëtarët prokurorë kthehen në vendet e mëparshme të punës. Mandati i prokurorit të posaçëm pezullohet gjatë kohës që ushtron funksionin si anëtar i KLP-së. Anëtarët joprokurorë që përpara emërimit punonin me kohë të plotë në sektorin publik, rikthehen në vendet e mëparshme të punës ose në pamundësi, në detyra të barasvlershme me to (neni 149.10 **KShq**).

KLP-ja ushtron këto përgjegjësi: a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon prokurorët e të gjitha niveleve; b) vendos për masat disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve; c) i propozon Kuvendit kandidatët për prokurorë të përgjithshëm, sipas ligjit; ç) miraton rregullat për etikën e prokurorëve dhe mbikëqyr respektimin e tyre; d) propozon dhe administron buxhetin e tij; dh) informon publikun dhe Kuvendin mbi gjendjen e prokurorisë; e) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj (neni 149/a., parag. 1 **KShq**). Ligji mund të parashikojë krijimin e komisioneve vendimmarrëse pranë **KLP** (neni 149/a., parag. 2 **KShq**).

Mandati i anëtarit të **KLP-së** mbaron kur: a) mbush moshën e pensionit; b) përfundon mandatin 5-vjeçar; c) jep dorëheqje; ç) shkarkohet sipas nenit 149/c të kushtetutës; d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit; dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën (neni 149/b., parag. 1 **KShq**). Mbarimi i mandatit deklarohet me vendim të KLP (neni 149/b., parag. 2 **KShq**). Kur vendi i anëtarit mbetet vakant, organi që ka emëruar anëtarin paraardhës, sipas nenit 149, emëron një anëtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të anëtarit të larguar (neni 149/b., parag. 3 **KShq**). Anëtari i KLP-së qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, përveç rasteve të parashikuara në nënparagrafët ”c”, “ç”, “d” dhe ”dh”, të paragrafit 1, të këtij neni (neni 149/b., parag. 4 **KShq**).

Prokurori i Përgjithshëm dhe anëtari i KLP-së mban **përgjegjësi disiplinore**, sipas ligjit (neni 149/c., parag. 1 **KShq**). Prokurori i Përgjithshëm dhe anëtari i KLP-së **shkarkohen** nga GJKSH-ja kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike; b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi (parag. 149/c., parag. 2 **KShq**). Prokurori i Përgjithshëm dhe anëtari i KLP-së **pezullohet nga detyra** me vendim të GJKSH-së kur: a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal ”arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale; b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje; c) fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit (neni 149/c., parag., 3 **KShq**). Qenia Prokuror i Përgjithshëm, prokuror ose anëtar i KLP-së nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore ose politike, si dhe me veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik ose shkencor (neni 149/ç i **KShq**).

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED) kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kritereve profesionale e morale të kandidatëve për ILD, si dhe të kandidatëve për anëtarë të GJKSH-së. KED-i shqyrton dhe rendit kandidatët sipas meritës profesionale. Renditja e kandidatëve nuk është e detyrueshme, me përjashtim të rastit kur nuk arrihet të emërohet kandidati (neni 149/d., parag. 1 i **KShq**). KED-i mblidhet sa herë është e nevojshme (neni 149/d., parag. 2 i **KShq**). KED-i përbëhet nga 9 anëtarë të përzgjedhur me short, nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ndaj të cilëve nuk është dhënë masë disiplinore. Ata ushtrojnë detyrën me mandat njëvjeçar, që fillon në datën një janar të çdo viti kalendarik. Presidenti i Republikës përzgjedh me short, midis datave 1 dhe 5 dhjetor të çdo viti kalendarik, dy gjyqtarë nga GJKSH-ja, një gjyqtar nga GJLSH-ja, një prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme, dy gjyqtarë dhe dy prokurorë nga gjykatat e apelit, si dhe një gjyqtar nga gjykatat administrative. Nëse Presidenti i Republikës nuk arrin t’i zgjedhë anëtarët deri në datën 5 dhjetor, Kryetari i Kuvendit i zgjedh ata me short brenda datës 10 dhjetor të atij viti kalendarik. Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në procedurën e hedhjes së shortit si dhe në mbledhjet dhe veprimtarinë e **KED** (neni 149/d., parag. 3 i **KShq**). Kryetar i KED-it është anëtari i GJLSH-së, e cila krijon kushtet e punës për ushtrimin e veprimtarisë së KEDit (neni 149/d., parag. 4 i **KShq**). Kritere të tjera për shkallën e kualifikimit të kandidatëve që marrin pjesë në short parashikohen me ligj. Organizimi dhe funksionimi i KED-it rregullohet me ligj (neni 149/d., parag. 5 i **KShq**).

23. Sistemi drejtësisë në Maqedoninë e Veriut

Në kapitullin e katërt të pjesës së tretë të **KMVe**, nenet 98-105 i kushtohen gjyqësisë së rregullt, kurse nenet 106-107 të kapitullit në vijim kanë të bëjnë me prokurorinë publike. Sikundër shihet, dispozitat kushtetuese janë më të pakta për sistemin e drejtësisë në **Maqedoninë e Veriut**, krahasuar me

Shqipërinë. Në fakt, dispozitat mbi sistemin e drejtësisë në **KShq** janë më të shumta në krahasim me krejt vendet e rajonit për shkak të procesit të vetingut, i cili ka vite që ka nisur në Shqipëri dhe nuk ka të sosur. Për pasojë, ka pasur nevojë të futen dispozita të detajuara për sistemin e drejtësisë, për të akomoduar dimensionin kushtetues të këtij procesi dhe për të ruajtur garancionet kushtetuese të atyre që do t'i nënshtrohen **vetinguit në drejtësi**. Shtjellimet tona për Maqedoninë e Veriut i ndajmë në dy pjesë, e para që tregon zgjidhjet kushtetuese origjinale dhe, e dyta, që tregon zgjidhjet kushtetuese që janë vënë me amendamentet e mëpastajme. Në këtë mënyrë, lexuesi do të ketë mundësi për të parë evoluimin e sistemit të drejtësisë në këtë vend fqinj me Kosovën.

Edhe këtu, neni parë nis me konstatimin se pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat (neni 98.1 i **KMVe**). Gjykatat janë të mëvetësishme dhe të pavarura. Gjykatat gjykojnë në bazë të KMVe e të ligjeve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me KMVe (neni 98.2 i **KMVe**). Organizimi i gjyqësisë është unik (neni 98.3 i **KMVe**). Ndalohen gjykatat e jashtëzakonshme (neni 98.4 i **KMVe**). Llojet, kompetencat, themelimi, suprimimi, organizimi dhe përbërja e gjykatave, si dhe procedura para tyre, rregullohen me ligj, i cili nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve (neni 98.5 i **KMVe**).

Gjyqtari zgjidhet për një mandat të pakufizuar kohor (neni 99.1 i **KMVe**). Gjyqtari nuk mund të transferohet kundër vullnetit të tij (neni 99.2 i **KMVe**). Gjyqtari shkarkohet: nëse atë e kërkon vetë; nëse e humb përgjithmonë aftësinë e ushtrimit të funksionit të gjyqtarit, të cilën e verifikon Këshilli Gjyqësor Republikan (KGJMVe); nëse i plotëson kushtet për pension pleqërie; nëse është dënuar për vepër penale me dënim të pakusht me burg me më së paku gjashtë muaj; për shkak të shkeljes së rëndë disiplinore të përcaktuar me ligj, që e bën të padenjë për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit, që e verifikon **KGJMVe**; dhe për shkak të ushtrimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit, të cilin në procedurë të përcaktuar me ligj e verifikon KGJK (neni 99.3 i **KMVe**).
Gjyqtarët gëzojnë **imunitet** (neni 100.1 i **KMVe**). Për imunitetin e gjyqtarëve vendos Kuvendi (neni 100.2 i **KMVe**). Funksioni i gjyqtarit nuk pajtohet me ushtrimin e funksionit dhe profesionit tjetër publik ose me anëtarësimin në parti politike (neni 100.3 i **KMVe**). Ndalohet organizimi dhe veprimi politik në gjyqësi (neni 100.4 i **KMVe**).

Gjykata Supreme (GJSMVe) është gjykata më e lartë në Maqedoninë e Veriut, e cila siguron unitetin në zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave (neni 101 i **KMVe**). Shqyrtimi para gjykatave dhe shqiptimi i aktgjykimit janë publik (neni 102.1 i **KMVe**). Publiku mund të përjashtohet në raste të përcaktuara me ligj (neni 102.2 i **KMVe**). Gjykata gjykon në kolegj (neni 103.1 i **KMVe**). Me ligj përcaktohet kur gjyqtari gjykon si gjyqtar i vetëm (neni 103.2 i **KMVe**). Në gjykim marrin pjesë edhe gjyqtarë porotë kur kjo është përcaktuar me ligj (neni 103.3 i **KMVe**). Gjyqtarët porotë nuk mund të merren në përgjegjësi për mendimin e shprehur dhe për votën e dhënë me rastin e marrjes së vendimeve gjyqësore (neni 103.4 i **KMVe**).

KGJMVe e përbëjnë shtatë anëtarë (neni 104.1 i **KMVe**). Kuvendi i zgjedh anëtarët e tij (neni 104.2 i **KMVe**). Anëtarët e KGJMve zgjidhen nga radhët e juristëve të shquar me mandat gjashtëvjeçar, me të drejtë edhe për një zgjedhje (neni 104.3 i **KMVe**). Ata gëzojnë imunitet (neni 104.4 i **KMVe**). Për imunitetin e tyre vendos Kuvendi (neni 104.5 i **KMVe**). Funksioni anëtarit të KGJK-së nuk pajtohet me ushtrimin e funksioneve dhe profesioneve të tjera publike ose me anëtarësimin në parti politike (neni 104.6 i **KMVe**).

Kompetencat e **KGJMVe** përcaktohen me nenin 105 të KMVe. Ato janë: i propozon Kuvendit zgjedhjen dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe e përcakton propozimin për shkarkimin nga funksioni i gjyqtarit në rastet e përcaktuara me KMVe; vendos për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve; vlerëson profesionalizmin dhe ndërgjegjen e gjyqtarëve gjatë ushtrimit të funksionit të tyre; dhe propozon dy gjyqtarë të **GJKMVe**.

Prokuroria Publike është organ unik dhe i mëvetësishëm shtetëror i cili i ndjek kryerësit e veprave penale dhe të veprave të tjera të ndëshkueshme të përcaktuara me ligj dhe kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj (neni 106.1 i **KMVe**). Prokuroria Publike funksionet e veta i ushtron në bazë dhe në kuadër të KMVe dhe ligjit (neni 106.2 i KMVe). Prokurorin Publik e emëron dhe shkarkon Kuvendi në kohëzgjatje prej gjashtë vitesh. Ai gëzon imunitet (neni 107.1 i **KMVe**). Për imunitetin e tij vendos Kuvendi (neni 107.2 i **KMVe**). Funksioni Prokuror Publik nuk pajtohet me ushtrimin e funksionit dhe profesionit tjetër publik ose me anëtarësimin në parti politike (neni 107.3 i **KMVe**).

Sikundër u tha, në ndërkohë që është miratuar **KMVe**, në sistemin e drejtësisë kanë ndodhur ndryshime që janë përcjellë me amendamentimet përkatëse kushtetuese. Sikundër do të shihet, ndryshimet kanë natyrë të njëjtë më zgjedhjet kushtetuese në Kosovë dhe në vendet përreth sa i përket gjyqësorit dhe sistemit të drejtësisë në përgjithësi dhe trupave të tyre rregullativ (këshillave gjyqësore dhe këshillave prokurorial). Dallimet janë në nuanca dhe vetëm në aspektin terminologjik, kurse përmbajtja ngelet e njëjtë dhe në funksion të sigurimit dhe garantimit të një pushtetit gjyqësor autonom dhe të pavarur e profesional. Të shohim si duket kjo në vazhdim.

Me amendamentin e datës 16 nëntor 2001, amendamenti XIV, është shtuar paragrafi i dytë i nenit 104 të **KMVe** dhe është thënë se votimi i tre anëtarve të **KGJMVe** duhet të ketë brenda votën e shumicës absolute të numrit të përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë në **Maqedoninë e Veriut**. Ndryshimet më rrënjësore në sistemin e drejtësisë në Maqedoninë e Veriut, megjithatë, kanë ndodhur më 7 dhjetor 2005. Ato ndryshime nuk ndjekin renditjen e dispozitave kushtetuese origjinale dhe janë bërë në kohë të ndryshme dhe për pjesë të ndryshme të KMVe. Këtu japim ashtu siç janë bërë amendamentimet, në rendin kronologjik sipas numrave romak, por që mbajnë datën e njëjtë – 17 dhjetor 2005. Me **amendamentin XXII** përcaktohet që Presidenti Republikës propozon dy anëtarë të KGJMve; **Amendamenti XXIV** ka përcaktuar që Qeveria propozon Kryeprokurorin e Maqedonisë së Veriut, pas marrjes së mendimit të Këshillit Prokurorial (KPMVe). **Amendamenti XXV** në tërësi ka zëvendësuar nenin 98 të KMVe që definonte fizionominë e gjyqësorit në këtë vend, ashtu që përcaktohet si vijon: "Pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat. Gjykatat janë autonome dhe të pavarura. Gjykatat gjykojnë në bazë të KMVe dhe ligjeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me KMVe. Gjykatat e jashtëzakonshme ndalohen. Llojet e gjykatave, sfera e kompetencave të tyre, themelimi, suprimimi, organizimi dhe përbërja, si dhe procedura që ndjekin rregullohen me ligj që miratohet me dy të tretat e votave të krejt deputetëve të Kuvendit". **Amendamenti XXVI** normon ndryshe mandatin e gjyqtarëve dhe ka zëvendësuar paragrafin e tretë të nenit 99 të KMVe, duke përcaktuar si vijon: "Mandati i gjyqtarit përfundon: nëse ajo/ai kërkon një gjë të tillë; nëse ajo/ai përherë humbë aftësinë për të kryer detyrat e gjyqtarit, e cila përcaktohet me vendim të **KGJMve**; nëse ajo/ai plotëson kushtet e pensionit të pleqërisë; nëse ajo/ai gjykohet për një vepër penale me burgim më së paku prej gjashtë muajve; nëse ajo/ai zgjidhet apo caktohet në ndonjë pozitë tjetër publike, përveç rasteve kur funksioni i saj/tij pezullohet sipas kushteve të përcaktuara me ligj". Në po këtë amendament janë dhënë edhe kushtet për shkarkim të gjyqtarit në Maqedoninë e Veriut. Kjo ndodhë për shkaqet si vijon: "Nëse ajo/ai kryen lëndim serioz disiplinor që e bën të padenjë për ushtrimin e detyrës së gjyqtarit, sipas ligjit dhe nëse ajo/aji kryen detyrën e gjyqtarit në mënyrë joprofesionale dhe joetike, sipas ligjit". **Amendamenti XXVII** ka sqaruar tutje çështjen e imunitetit të gjyqtarëve dhe papajtueshmëria e funksionit të gjyqtarit me detyrat tjera.

Gjyqtari nuk mund të mbahet përgjegjës për mendimin e dhënë në procesin e nxjerrjes së vendimit gjyqësor. Gjyqtari nuk mund të arrestohet pa pëlqimin e KGJMVe, Përveç rasteve kur kapet **in flagrantia** në kryerje të veprës penale për të cilën dënimi është së paku gjashtë vite burgim. Funksioni gjyqësor, ndërkaq, sipas këtij amendamenti, konsiderohet i papajtueshëm me anëtarësinë në ndonjë parti politike ose me ndonjë funksion publik ose profesion, sipas ligjit. Me dispozitën mbi imunitetin në këtë amendament është zëvendësuar paragrafi 2 i nenit 100 të KMVe kurse me dispozitën mbi papajtueshmërinë është zëvendësuar paragrafi 3 i nenit 100 të KMVe. **Amendamenti XXVIII** normon rolin dhe pozitën kushtetuese të KGJMVe. Ky organ definohet si një institucion i pavarur dhe autonom i gjy-

qësorit, i cili ka për detyrë të siguroj dhe garantoj pavarësinë dhe autonominë e gjyqësorit. Ai përbëhet prej pesëmbëdhjetë anëtarëve. Presidenti i GJSMVe dhe Ministri Drejtësisë janë anëtarë **ex officio** i KGJMVe. Tetë anëtarë zgjidhen nga gjyqtarët. Tre prej tyre i takojnë komuniteteve që nuk janë në shumicë në Maqedoninë e Veriut, duke siguruar përfaqësimin e barabartë të shtetasve të të gjitha komuniteteve. Tre anëtarë të KGJMVe zgjidhen nga Kuvendi me shumicën e votave të numrit të tërësishëm të tij dhe me shumicën e votave të komuniteteve joshumicë në Maqedoninë e Veriut. Dy anëtarë të **KGJMVe** propozohen nga Presidenti Republikës dhe zgjidhen nga Kuvendit, njëri prej tyre duhet të jetë nga komunitetet joshumicë në vend. Anëtarët e KGJMVe të zgjedhur nga Kuvendi, me propozimin e Presidentit të Republikës, duhet të jenë jurist nga universitetet vendit dhe juristë të njohur. Anëtarët në **KGJMVe** zgjidhen për gjashtë vite, me të drejtën për rizgjedhje edhe njëherë. Kriteret dhe mënyra e zgjedhjes, si dhe baza e procedura për përfundimin e mandatit të anëtarëve të KGJMVe për caktohen me ligj. Detyra e anëtarit të këtij organi është e papajtueshme me anëtarësimin në parti politike dhe me ushtrimin e detyrave të tjetra publike dhe profesioneve, sipas ligjit. Ky amendament ka zëvendësuar nenin 104 të KMVe. **Amendamenti XXIX** ka përcaktuar **kompetencat** e **KGJMVe**, ashtu siç janë edhe sot dhe që nuk dallojnë nga kompetencat e këshillave gjyqësore të vendeve përreth Kosovës. KGJMVe zgjedhë dhe shkarkon gjyqtarët dhe gjyqtarët porotë; konstaton mbarimin e detyrës së gjyqtarit; zgjedhë dhe shkarkon kryetarët e gjykatave; mbikëqyr dhe vlerëson punën e gjyqtarëve dhe vendos për përgjegjësinë e tyre; ka autorizim për të revokuar imunitetin e gjyqtarëve; propozon dy gjyqtarë për **GJKMVe** nga radha e gjyqtarëve; dhe kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj. Me rastin e zgjedhjes së gjyqtarëve, gjyqtarëve porotë dhe kryetarëve të gjykatave, përfaqësimi i barabartë i qytetarëve që iu takojnë të gjitha komuniteteve duhet të respektohet. KGJMVe paraqet raport vjetor në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut, në mënyrën, përmbajtjen dhe formën e përcaktuar me ligj. Me këtë amendament janë zëvendësuar dispozitat e nenit 105 të KMVe dhe është fshirë fjalia e 15 e paragrafit 1 të nenit 68 të KMVe. **Amendamenti XXX** ka të bëj me **zyrën e organit të akuzës** në **Maqedoninë e Veriut**, të cilit e ripërcakton shumë më ndryshe nga versioni origjinal i **KMVe**, i diskutuar më sipër. Prokurori Publik i kryen detyrat e veta në bazë të **KMVe** dhe ligjit, marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, në pajtim me **KMVe**, thuhet në pikën e parë të këtij amendamenti. Ky funksion ushtrohet nga kryeprokurori dhe prokurorët publik të **Maqedonisë së Veriut** (pika e dytë e amendamentit). Kompetencat, themelimi, suprimimi, organizimi dhe funksionimi i zyrës së prokurorit publik përcaktohet me ligj, që miratohet me dy të tretat e votave të numrit të tërësishëm të deputetëve në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut. Kryeprokurori caktohet dhe shkarkohet nga Kuvendi për një mandat prej gjashtë vjetëve, me të drejtë rizgjedhjeje. Prokurorët publik zgjidhen nga **KPMVe** dhe mandati i tyre nuk ka kufizime kohore. Me rastin e zgjedhjes së prokurorëve publik, përfaqësimi i barabartë i qytetarëve që iu takojnë të gjitha komuniteteve duhet të respektohet. **KPMVe** vendos për shkarkimin e prokurorëve. Kompetenca, përbërja, struktura, kohëzgjatja e detyrës së anëtarëve të **KPMVe**, baza dhe procedura për mbarimin e mandatit dhe shkarkimin e anëtarëve të **KPMVe** përcaktohen me ligj. Ky amendament normon edhe çështjen e papajtueshmërisë: funksioni i kryeprokurorit dhe prokurorëve në **Maqedoninë e Veriut** është i papajtueshëm me anëtarësimin në parti politike ose me ushtrimin e ndonjë funksioni publik dhe profesionit tjetër, sipas ligjit. Organizimi politik dhe aktiviteti politik brenda organi të akuzës rreptësisht janë të ndaluar. Me këtë amendament janë zëvendësuar paragrafët 2 dhe 3 të nenit 106 të **KMVe** dhe është fshirë neni 107 i **KMVe** në tërësi.

24. Sistemi drejtësisë në Mal të Zi

Sistemi i drejtësisë në **KMZi** rregullohet në dy kapituj të ndarë, jo një pas një si në Kosovë e vendet tjera përreth, po ndaras: kapitulli i 5 (nenet 118-128 të **KMZi**) normojnë pushtetin gjyqësor dhe organet që e ushtrojnë atë, kurse kapitulli 8 rregullon organin e akuzës malazeze (nenet 134-138 i **KMZi**). Dy kapitujt mes tyre rregullojnë pozitën kushtetuese të ushtrisë, këshillit të sigurisë, çështjen e gjendjes së luftës dhe gjendjen e jashtëzakonshme. E përbashkëta e këtyre kapitujve është se gjenden në pjesën e tretë që rregullon marrëdhëniet e pushtetit.

Kapitulli mbi gjyqësinë nis me parimet e gjyqësisë (neni 118 i KMZi). Gjykatat janë të pavarura (neni 118.1 i **KMZi**). Gjykatat gjykojnë në bazë të **KMZi**, ligjit dhe marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare (neni 118.2 i **KMZi**). Ndalohet themelimi i gjykatave të jashtëzakonshme dhe të momentit (neni 118.3 i **KMZi**). Gjykata gjykon në kolegj, përveç rasteve kur me ligj caktohet që gjykon gjyqtari individual (neni 119.1 i **KMZi**). Në gjykim marrin pjesë gjyqtarët porotë, kur kjo përcaktohet me ligj (neni 119.2 i **KMZi**). Gjykimi është publik dhe vendimet jepen publikisht (neni 120.1 i **KMZi**). Gjykata përjashtimisht mund të përjashtoj publikun nga shqyrtimi apo nga një pjesë e tij për arsye që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike, vetëm në atë masë që është e domosdoshme: në interes të moralit, rendit publik, kur bëhet fjalë më të mitur, për mbrojtjen e jetës private të palëve, në kontestet martesore, në procedura lidhur me kujdestarinë dhe adoptimin, me qëllim të ruajtjes së sekretit ushtarak, zyrtar ose afarist dhe shkaku sigurisë dhe mbrojtjes së Malit të Zi (neni 120.2 i **KMZi**).

Funksioni gjyqtarit është i përhershëm (neni 121.1 i **KMZi**). Gjyqtarit i **përfundon** funksioni kur vetë kërkon një gjë të tillë, kur plotëson kushtet e realizimit të pensionit të pleqërisë dhe kur dënohet me dënim me burgim efektiv (neni 121.2 i **KMZi**). Gjyqtari **shkarkohen nga detyra**, ndërkaq, në këto raste: kur dënohet për një vepër që e bën të padenjë për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit; kur ushtron funksionin e gjyqtarit në mënyrë joprofesionale dhe pa ndërgjegje apo nëse humb aftësinë e për ushtrimin e funksioni të gjyqtarit në mënyrë të përhershme (neni 121.3 i **KMZi**). Gjyqtari nuk mund të bartet ose dërgohet në një gjykatë tjetër pa vullnet, p**ërveç nëse me vendim të Këshillit Gjyqësor të Malit të Zi** (KGJMZi) në rastet e riorganizimit të gjykatave (neni 121.4 i **KMZi**).

Rreth **imunitetit të gjyqtarëve, që në titull, neni 122 flet për imunitetin funksional**. Gjyqtari dhe gjyqtari porot gëzon imunitet funksional (neni 122.1 i **KMZi**). Gjyqtari dhe gjyqtari porot nuk mund të thirret në përgjegjësi për mendimin e shprehur dhe për votimin e bërë me rastin e miratimit të vendimit gjyqësor, p**ërveç kur bëhet fjalë për vepër penale (neni 122.2 i KMZi**). Gjyqtari, në procedurën e nisur për shkak të veprës penale të kryer gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, nuk mund të burgoset pa miratimin e KGJMZi (neni 122.3 i i **KMZi**). Lidhur me **papajtueshmërinë e funksionit të gjyqtarit me funksionet tjera flet neni 123 i KMZi**. Gjyqtari nuk mund të ushtroj funksionin e deputetit ose funksion tjetër e as të kryej veprimtari profesionale ose veprimtari tjetër (neni 123 i **KMZi**).

Gjykata Supreme (GJSMZi) është instanca më e lartë në Malin e Zi (neni 124.1 i **KMZi**). GJSMZi siguron zbatimin e njëjtë të ligjeve nga ana gjykatave dhe kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj (neni 124.2 i **KMZi**). Kryetarin e GJSMZi e zgjedh dhe shkarkon KGJMZi me shumicën e dy të tretave, me propozim të seancës së përgjithshme të GJSMZi (neni 124.3 i **KMZi**). Kryetari i GJSMZi zgjidhet për pesë vite (neni 124.4 i **KMZi**). I njëjti person mund të zgjidhet me së shumti dy herë kryetar i GJSMZi (neni 124.5 i **KMZi**). Gjyqtarët dhe kryetarët e gjykatave i zgjedh dhe shkarkon KGJMZi (neni 125.1 i **KMZi**). Kryetari gjykatës zgjidhet për pesë vite (neni 125.2 i **KMZi**) dhe nuk mund të jetë anëtar i KGJMZi (neni 125.3 i **KMZi**).

KGJMZi është një organ autonom dhe i pavarur që siguron pavarësinë dhe autonominë e gjykatave dhe gjyqtarëve (neni 126 i **KMZi**). Ai përbehet nga kryetari dhe nëntë anëtarë (neni 127.1 i **KMZi**). Anëtarë të KGJMZi janë: kryetari GJSMZi; 2. Katër gjyqtarë që i zgjedhë dhe shkarkon Konferenca e Gjyqtarëve. Duke pasur parasysh përfaqësimin e barabartë të gjykatave dhe gjyqtarëve; 3. Katër juristë të njohur që i zgjedh dhe shkarkon Kuvendi, me propozim të trupës punuese kompetente të Kuvendit, sipas ftesës së hapur publike; ministri kompetent për çështjet e drejtësisë (neni 127.2 i **KMZi**). Kryetari i KGJMZi zgjidhet nga radha e anëtarëve të tij, që nuk janë bartës të funksionit gjyqësor, me votat e dy të tretave të anëtarëve të vet (neni 127.3 i **KMZi**). Për kryetar të KGJMZi nuk mund të jetë ministri i ngarkuar me çështjet e drejtësisë (neni 127.4 i **KMZi**). Kryetari i KGJMZi ka votën e dyfishtë në rast të votës së barabartë (neni 127.5 i **KMZi**). Përbërjen e KGJMZi e shpall presidenti i Malit të Zi (neni 127.6 i **KMZi**). Mandati i **KGJMZi** është katër vite (neni 127.7 i **KMZi**). Neni i fundit i këtij kapitulli, neni 128, përcakton kompetencat e KGJMZi të cilat janë si vijon: 1. Zgjedh dhe shkarkon kryetarin e GJSMZi; 2.

Zgjedh dhe shkarkon kryetarin e KGJMZi; 3. I raporton një herë në vit Kuvendit të Malit të Zi mbi punën e vet dhe gjendjen e përgjithshme në gjyqësorin e vendit; 4. Zgjedh dhe shkarkon gjyqtarët, kryetarët e gjykatave dhe gjyqtarët porotë; 5. Shqyrton raportin mbi punën e gjyqtarëve, parashtresat dhe ankesat për punën e gjykatave dhe merr qëndrim lidhur me to; 6. Konstaton ndërprerjen e funksionit të gjyqtarit; 7. Konstaton numrin e gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë; 8. I propozon qeverisë shumën e mjeteve për punën e gjykatave; 9. Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj (neni 128.1 i **KMZi**). KGJMZi vendos me shumicën e votave të krejt anëtarëve të tij, Përveç rasteve kur ndryshe përcaktohet me KMZi (neni 128.2 i **KMZi**). Në procedurat e përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve, ministri kompetent për punët e drejtësisë nuk voton (neni 128.3 i **KMZi**).

Prokuroria shtetërore është organ unik dhe i pavarur shtetëror që kryen punët e ndjekjes së kryesve të veprave penale dhe veprave të tjera që ndiqen sipas detyrës zyrtare (neni 134 i **KMZi**). Punët e Prokurorisë shtetërore i kryejnë udhëheqësit e prokurorive dhe prokurorët shtetërorë (neni 135.1 i **KMZi**). Kryeprokurorin e Shtetit e zgjedh dhe shkarkon Kuvendi Malit të Zi pas dëgjimit në trupën punuese të Kuvendit, me propozim të Këshillit Prokurorial (KPMZi), sipas konkursit të shpallur (neni 135.2 i **KMZi**). Kryeprokurori dhe udhëheqësit e prokurorive zgjidhen në mandat prej pesë viteve (neni 135.3 i **KMZi**). Funksioni i prokurorit shtetëror është i përhershëm. Përjashtimisht, personi që zgjidhet për herë të parë ka mandat prej katër viteve (neni 135.4 i **KMZi**). Udhëheqësit të prokurorisë shtetërore dhe prokurorit shtetëror i ndërpritet funksioni dhe shkarkohet në rastet dhe sipas procedurës së përcaktuar me ligj (neni 135.5 i **KMZi**). Udhëheqësi prokurorisë shtetërore dhe prokurori shtetëror shkarkohen nga funksioni nëse dënohet me vendim të formës së prerë më burgim efektiv (neni 135.6 i **KMZi**).

KPMZi siguron pavarësinë e prokurorisë shtetërore (neni 136.1 i **KMZi**). Kryeprokurori kryeson me KPMZi, Përveç në rastet e procedurave disiplinore (neni 136.2 i **KMZi**). Përbërja, zgjedhjet, mandati, organizimi dhe mënyra e punës së KPMZi rregullohet me ligj (136.3 i **KMZi**). Ky organ ka këto **kompetenca**: 1. Vërteton propozimin për zgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit; 2. Zgjedh**ë** dhe shkarkon udhëheqësit e prokurorive shtetërore dhe prokurorët shtetërorë; vërteton ndërprerjen e funksionit të udhëheqësve të prokurorive shtetërore dhe prokurorëve shtetërorë; 4. I propozon qeverisë shumën e mjeteve për punën e prokurorisë së shtetit; i raporton Kuvendit një herë në vit mbi punën e prokurorisë shtetërore; 6. Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj (neni 136.4 i **KMZi**). KPMZi vendos me shumicën e votave të anëtarëve të vet (neni 136.5 i **KMZi**).

Udhëheqësi prokurorisë shtetërore dhe prokurori shtetëror gëzojnë **imunitet funksional** dhe nuk mund të thirren në përgjegjësi për mendimin e dhënë ose vendimin e marrë në ushtrim të funksionit të tyre, Përveç nëse bëhet fjalë për vepër penale (neni 137 i **KMZi**). Udhëheqësi i prokurorisë shtetërore dhe prokurori shtetëror nuk mund të ushtrojnë funksionin e deputetit dhe funksion tjetër publik e as të kryej punë profesionale ose ushtroj veprimtari tjetër (neni 138 i **KMZi**).

25. Sistemi drejtësisë në Serbi

Për dallim nga **KMZi**, kushtetutëbërësi serb ka normuar sistemin e drejtësisë në dy kapituj me radhë, kapitullin 7 (nenet 142-155) dhe 8 (156-165), në kuadër të pjesës së pestë që rregullon pushtetin. Me amendamentet e 30 nëntorit 2021, sistemi i drejtësisë ka pësuar ndryshime të konsiderueshme. Për këtë arsye, ne në vazhdim japim zgjidhjet origjinale kurse në fund të seksionit japim një nga një **amendamentet** me të cilat janë bërë ndryshime në sistemin aktual të drejtësisë serbe.

Pushteti gjyqësor është unik në territorin e Republikës së Serbisë (neni 142.1 i **KSerb**). Gjyqet janë autonome dhe të pavarura në punën e tyre dhe gjykojnë në bazë të KSerb, ligjit dhe akteve të tjera të përgjithshme, sipas ligjit, si dhe rregullave përgjithësisht të pranuara të së drejtës ndërkombëtare dhe marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare (neni 142.2 i **KSerb**). Shqyrtimi në gjykatë është publik dhe mund të kufizohet vetëm sipas KSerb (neni 142.3 i **KSerb**). Në gjykim marrin pjesë gjyqtarët dhe

gjyqtarët porotë dhe në raste të caktuara gjykojnë vetëm gjyqtarët profesionalë (neni 142.4 i **KSerb**). Në gjykim marrin pjesë gjyqtarët dhe gjyqtarët porotë, sipas ligjit (neni 142.5 i **KSerb**). Me ligj mund të përcaktohet që në disa gjykata dhe në disa çështje të gjykojnë vetëm gjyqtarët profesionalë (neni 124.6 i **KSerb**). Gjykata gjykon në kolegj, me ligj mund të përcaktohet që në disa çështje të gjykoj gjyqtari i vetëm (neni 124.6 i **KSerb**).

Pushteti gjyqësor në Republikën e Serbisë i takon gjykatave të kompetencës së përgjithshme dhe të kompetencës së posaçme (neni 143.1 i **KSerb**). Themelimi, organizimi, kompetenca, rregullimi dhe përbërja e gjykatave rregullohen ligj (neni 143.2 i **KSerb**). Nuk mund të themelohen gjykata të përkohshme, të jashtëzakonshme dhe të çastit (neni 143.3 i **KSerb**). **GJSSerb** është instanca më e lartë në Republikën e Serbisë (neni 143.4 i **KSerb**). Selia e **GJSSerb është në Beograd (neni 143.5 i KSerb**). Kryetarin e saj e zgjedh Kuvendi, me propozimin e **KLGJSerb**, pas marrjes së mendimit të **Seancës së Përgjithshme të GJSSerb** dhe të trupës kompetente të Kuvendit (neni 144.1 i **KSerb**). Kryetari zgjidhet për pesë vite dhe nuk mund të rizgjidhet (neni 144.2 i **KSerb**). Funksioni i kryetarit të GJSSerb ndërpritet para kohës për të cilën është zgjedhur nëse vetë kërkon një gjë të tillë, me plotësimin e kushteve ligjore për ndërprerje të funksionit gjyqësor ose me shkarkim në pajtim me shkaqet ligjore për shkarkim të kryetarit të gjyqit (neni 144.3 i **KSerb**). Vendimin për ndërprerje të funksionit të kryetarit të GJSSerb i merr Kuvendi, sipas ligjit, kurse vendimin për shkarkim e merr në propozim të **KLGJSerb** (neni 144.4 i **KSerb**).

Vendimet gjyqësore jepen në emër të popullit (neni 145.1 i **KSerb**). Ato bazohen në KSerb, ligjin, marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare dhe dispozitat e miratuara në bazë të ligjit (neni 145.2 i **KSerb**). Vendimet janë të detyrueshme për të gjithë dhe nuk mund të jenë objekt i kontrollit jashtëgjyqësor (neni 145.3 i **KSerb**) dhe mund kontrollohen vetëm nga gjykata kompetente, sipas ligjit (neni 145.4 i **KSerb**). Me falje ose amnisti, dënimi shqiptuar mund, pa vendim gjyqësor, të falet në tërësi ose pjesërisht (neni 145.5 i **KSerb**).

Funksioni gjyqtarit është i përhershëm (neni 146.1 i KSerb). Përjashtimisht, personi që zgjidhet për herë të parë, mund të ketë mandat prej tri viteve (neni 146.2 i **KSerb**). Kuvendi, me propozim të KLGJSerb, zgjedh për gjyqtar personin që zgjidhet për herë të parë në funksionin e gjyqtarit (neni 147.1 i **KSerb**). Mandati që për herë të parë fitohet, zgjat tri vite (neni 147.2 i **KSerb**). KLGJSerb, sipas ligjit, zgjedh gjyqtarët për ushtrim të përhershëm të funksionit gjyqësor, në të njëjtën gjykatë ose në një tjetër (neni 147.3 i **KSerb**). KLGJSerb vendos edhe për zgjedhjen e gjyqtarëve që janë në funksion permanent gjyqësor në një gjykatë tjetër ose në gjykatë të lartë (neni 147.4 i **KSerb**). Funksioni gjyqtarit ndërpritet me kërkesën e gjyqtarit, me paraqitjen e kushteve ligjore ose me shkarkim sipas ligjit, si dhe nëse nuk zgjidhet në funksion permanent si gjyqtar (neni 148.1 i **KSerb**). Vendimin për ndërprerjen e funksionit të gjyqtarit e merr KLGJSerb. Kundër vendimit gjyqtari ka të drejtën e ankesës në GJKSerb. Ankesa përjashton përdorimin e ankesës kushtetuese (neni 148.2 i **KSerb**). Procedura, bazat dhe arsyet për ndërprerje të funksionit të gjyqtarit, si dhe arsyet për shkarkim nga detyra e kryetarit të gjykatës, përcaktohen me ligj (neni 148.3 i **KSerb**).

Gjyqtari është i pavarur në ushtrimin e detyrës së gjyqtarit dhe i nënshtrohet vetëm KSerb dhe ligjit (neni 149.1 i **KSerb**). Ndalohet çdo ndikim në gjyqtarin gjatë kryerjes së detyrës së gjyqtarit (neni 149.1 i **KSerb**). Gjyqtari ka të drejtë që të kryej funksionin e gjyqtarit në gjykatën për të cilën është zgjedhur dhe vetëm me pëlqimin e vet mund të transferohet ose dërgohet në një gjykatë tjetër (neni 150.1 i **KSerb**). Në rast të suprimimit të gjykatës ose të kompetencës kryesore të gjykatës për të cilën është zgjedhur, gjyqtari përjashtimisht mund të transferohet përgjithmonë, kundër vullnetit të vet, ose të dërgohet në një gjykatë tjetër, sipas ligjit (neni 150.2 i **KSerb**). Gjyqtari nuk mund të thirret në përgjegjësi për mendimin e shprehur ose votën e dhënë me rastin e marrjes së vendimit, Përveç nëse bëhet fjalë për vepër penale të shkeljes së ligjit nga ana e gjyqtarit (neni 151.1 i **KSerb**). Gjyqtari nuk mund të privohet nga liria në procedurën e nisur kundër saj/tij për shkak të veprës penale të kryer gjatë kryerjes së detyrës si gjyqtar, pa pëlqimin e **KLGJSerb** (neni 151.2 i **KSerb**). Ndalohet veprimi politik i gjyqtarëve (neni 152.1 i **KSerb**). Me ligj

përcaktohen funksionet tjera, punët ose interesat privat që nuk janë të pajtueshëm më funksionin e gjyqtarit (neni 152.2 i **KSerb**).

KLGJSerb është organ autonom dhe i pavarur që siguron dhe garanton pavarësinë dhe mëvetësinë e gjyqeve dhe gjyqtarëve (neni 153.1 i **KSerb**) dhe ka 11 anëtarë (neni 153.2 i **KSerb**). Në përbërjen e tij hyjnë kryetari i GJSSerb, ministri kompetent për çështjet e drejtësisë dhe kryetari i trupës kompetente të Kuvendit, si anëtar sipas pozitës, dhe tetë anëtar të zgjedhur nga Kuvendi, sipas ligjit (neni 153.3 i **KSerb**). Anëtarët e zgjedhur përbëhen nga gjashtë gjyqtarë me funksion të përhershëm, nga të cilët njëri nga territori i krahinave autonome, dhe dy juristë të njohur dhe me emër me më së paku 15 vite përvojë punë në profesion, nga të cilët njëri duhet të jetë avokat, kurse tjetri profesor i fakultetit juridik (neni 153.4 i **KSerb**). Kryetarët e gjykatave nuk mund të jenë nga radha e anëtarëve të KLGJSerb (neni 153.5 i **KSerb**). Mandati i KLGJSerb zgjat pesë vite, Përveç për anëtarët sipas pozitës (neni 153.6 i **KSerb**). Anëtari i KLGJSerb gëzon imunitetin e njëjtë si gjyqtarët (neni 163.7 i **KSerb**).

KLGJSerb ka këto kompetenca: zgjedh dhe shkarkon gjyqtarët, sipas KSerb dhe ligjit; i propozon Kuvendit zgjedhjen e gjyqtarëve me rastin e zgjedhjes së parë në funksionin e gjyqtarit; i propozon Kuvendit zgjedhjen e kryetarit të GJSSerb dhe kryetarët e gjykatave, sipas mënyrës së përcaktuar me Kserb dhe ligj; kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj(neni 154 i **KSerb**). Kundër vendimit të KLGJSerb mund të ushtrohet ankesë në GJKSerb, sipas ligjit (neni 155 i **KSerb**).

Prokuroria publike është organ shtetëror që ndjek kryesit e veprave penale dhe veprave të tjera të dënueshme dhe ndërmerr masa për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë (neni 156.1 i **KSerb**). Prokuroria kryen punën e saj në bazë të KSerb, ligjit, marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare dhe dispozitave të miratuara sipas ligjit (neni 156.2 i **KSerb**). Themelimi, organizimi dhe kompetenca e prokurorisë publike rregullohet me ligj (neni 157.1 i **KSerb**). Prokuroria Publike e Republikës është prokuroria më e lartë në Serbi (neni 157.2 i **KSerb**). Kryeprokurori i Republikës ushtron kompetencat e prokurorisë publike në kuadër të të drejtave dhe detyrave të Serbisë (neni 158.1 i **KSerb**). Kryeprokurorin e zgjedh Kuvendi Serbisë, me propozim të qeverisë dhe marrjes së mendimit të trupës kompetente të Kuvendit (neni 158.2 i **KSerb**). Kryeprokurori zgjidhet për gjashtë vjet dhe mund të rizgjidhet (neni 158.3 i **KSerb**). Funksioni i saj/tij ndërpritet nëse nuk zgjidhet sërish, nëse vet kërkon një gjë të tillë, me paraqitjen e kushteve ligjore ose me shkarkim për arsye të dhëna në ligj (neni 158.4 i **KSerb**). Vendimin për ndërprerje të funksionit të kryeprokurorit e merr Kuvendi, sipas ligjit, kurse vendimin për shkarkim e merr me propozim të qeverisë (neni 158.5 i **KSerb**).

Funksionin e prokurorisë publike e kryen prokurori publik (neni 159.1 i **KSerb**). Prokurorin publik e zgjedh Kuvendi, me propozim të qeverisë (neni 159.2 i **KSerb**). Mandati prokurorit publik zgjat gjashtë vite dhe mund të rizgjidhet (neni 159.3 i **KSerb**). Zëvendësprokurori zëvendëson prokurorin publik në kryerjen e funksionit të ndjekjes dhe detyrohet të punoj sipas udhëzimeve të tij (neni 159.4 i **KSerb**). Kuvendi, me propozim të Këshilli Prokurorial (KPSerb) zgjedh për zëvendës të prokurorit publik personin që për herë të parë zgjidhet në këtë funksion (neni 159.5 i **KSerb**). Mandati zëvendësprokurorit publik që zgjidhet për herë të parë zgjat tri vite (neni 159.6 i **KSerb**). **KPSerb**, sipas ligjit, zgjedh zëvendësit e prokurorëve publikë për ushtrim të përhershëm të funksionit, në të njëjtën prokurori publike ose në një tjetër (neni 159.7 i **KSerb**). **KPSerb** vendos edhe për zgjedhjen e zëvendës prokurorëve publikë që janë në funksion të përhershëm në një ose më shumë prokurori publike të tjera (neni 159.8 i **KSerb**).

Kryeprokurori përgjigjet për punën e porkurorisë publike dhe për punën e vet para Kuvendit (neni 160.1 i **KSerb**). Prokurorët publikë përgjigjen për punën prokurorisë publike dhe për punën e tyre Kryeprokurorit dhe Kuvendit, kurse prokurorët më të ulët drejtpërdrejt prokurorit më të lartë (neni 160.2 i **KSerb**). Zëvendësprokurorët përgjigjen për punën e tyre prokurorit publik (neni 160.3 i **KSerb**). Prokurorit dhe zëvendësprokurorit publik iu ndërpritet funksioni me kërkesën e tyre, me shfaqjen e rrethanave ligjore ose me shkarkim sipas ligjit. Prokurorit publik i ndërpritet funksioni edhe nuk rizgjidhet, kurse

zëvendësprokurorit, nëse nuk zgjidhet në funksion permanent (neni 161.1 i **KSerb**). Vendimi mbi ndërprerjen e funksionit të prokurorit publik sipas ligjit, e merr Kuvendi, kurse vendimin për shkarkim e merr me propozim të qeverisë (neni 161.2 i **KSerb**). Vendimin për ndërprerjen e funksionit të zëvendësprokurorit, sipas ligjit, e me KPSerb (neni 161.3 i **KSerb**). Kundër vendimit për ndërprerje të funksionit, prokurori publik dhe zëvendësprokurori publik mund të ushtrojnë ankesë në GJKSerb, e cila përjashton të drejtën për paraqitje të ankesës kushtetuese (neni 161.4 i **KSerb**). Procedurat, bazat dhe arsyet pët ndërprerje të funksionit të prokurorit publik dhe zëvendësit të prokurorit publik përcaktohen me ligj (neni 161.5 i **KSerb**).

Prokurori publik dhe zëvendësi i prokurorit publik nuk mund të thirren në përgjegjësi për mendimin e shprehur gjatë kryerjes së detyrës së ndjekjes, përveç nëse bëhet fjalë për vepër penale të shkeljes së ligjit nga ana e tyre (neni 162.1 i **KSerb**). Prokurori publik, përkatësisht zëvendësi prokurorit publik nuk mund të privohen nga liria në procedurën e ngritur kundër tyre për vepër penale të kryer gjatë kryerjes së funksionit, përkatësisht gjatë shërbimit, pa lejen e Kuvendit të Serbisë (neni 162.2 i **KSerb**).

Ndalohet veprimtaria politike e prokurorëve publikë dhe zëvendësve të tyre (neni 163.1 i **KSerb**). Me ligj përcaktohet cilat funksione të tjera, punë dhe interesa privat janë të papajtueshëm me funksionin e prokurorit publik (neni 163.2 i **KSerb**). Neni ne vijim, neni 164 i KSerb rregullon pozitën kushtetuese, përbërjen dhe zgjedhjen e organit rregullativ të organit serb të akuzës – KPSerb. Ky organ është organ i pavarur që siguron dhe garanton pavarësinë e prokurorëve publikë dhe zëvendësve të tyre, sipas KSer (neni 164.1 i **KSerb**). Përbëhet prej 11 anëtarëve (neni 164.2 i **KSerb**). Në përbërjen e tij hyjnë kryeprokurori i Serbisë, ministri kompetent për drejtësi dhe kryetari i trupës kompetente të Kuvendit, si dhe anëtarët sipas pozitës dhe tetë anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi, sipas ligjit (neni 164.3 i **KSerb**). Anëtarët e zgjedhur përbëhen nga gjashtë prokurorë publikë ose zëvendës prokurorësh publikë me funksion të përhershëm, nga të cilët një është nga territori i krahinave autonome, dhe dy juristë të njohur dhe në emër me përvojë së paku 15 vite në profesion, nga të cilët njëri duhet të jetë avokat e tjetri profesor i fakultetit juridik (neni 164.4 i **KSerb**). Mandati anëtarëve të **KPSerb** zgjat pesë vite, përveç për anëtarët sipas pozitës (neni 164.5 i **KSerb**). Anëtari i **KPSerb gëzon imunitet të njëjtë sikur prokurori publik (neni 164.6 i KSerb**). **KPSerb** ka këto kompetenca: i propozon Kuvendit kandidatët për zgjedhje të parë për zëvendësprokuror publik, zgjedh zëvendësprokurorët publikë për ushtrim permanent të funksionit të zëvendësit të prokurorit publik, zgjedh zëvendësit e prokurorëve publikë që janë në funksion permanent për zëvendës të prokurorëve në prokurorinë tjetër, vendos procedurën për ndërprerje të funksionit të zëvendës prokurorit publik, sipas **KSerb** dhe ligjit, kryen dhe punë të tjera të përcaktuara me ligj.

Me **amendamentin IV** është zëvendësuar neni 142 i **KSerb**. Pushteti gjyqësor i takon gjykatave, të cilat janë të pavarura (142.1 i **KSerb**). Pushteti gjyqësor është unik në tërë territorin e Serbisë (neni 142.2 i **KSerb**). Vendimet gjyqësore bihen në emër të popullit (neni 142.3 i **KSerb**). Vendimin gjyqësor mund ta kontrolloj vetëm gjykata kompetente, sipas procedurës së përcaktuar me ligj, si dhe GJKSerb sipas procedurës sipas ankesës kushtetuese (neni 142.3 i **KSerb**). Me falje ose amnisti, dënimi shqiptuar, pa vendim gjyqësor, mund të hiqet pjesërisht ose në tërësi (neni 142.4 i **KSerb**). Gjykimi në gjykatë është i hapur, kurse publiku mund të përjashtohet sipas KSerb (neni 142.5 i **KSerb**). Me ligj mund të caktohet që përveç gjyqtarëve, gjykojnë edhe gjyqtarët porotë (neni 142.6 i **KSerb**).

Me **amendamentin V** është zëvendësuar neni 143 i **KSerb**. Themelimi, suprimimi, llojet, kompetenca, fusha dhe selia e gjykatave, përbërja dhe procedurat para gjykatave rregullohen me ligj (neni 143.1 i **KSerb**). Gjykata më e lartë në Serbi është Gjykata Supreme (neni 143.2 i **KSerb**). Në versionin origjinal të KSerb të vitit 2006, aktualisht në fuqi, kjo gjykatë është quajtur Gjykata Supreme e Kasacionit, ngjashëm me modelin italian. Ndalohet themelimi i gjykatave të përkohshme, të jashtëzakonshme dhe të atypëratyshme (neni 143.3 i **KSerb**).

Me **amendamentin V**I është zëvendësuar neni 144 i **KSerb**. Gjyqtari është i pavarur dhe gjykojnë në bazë të KSerb, marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, ligjeve, rregullave përgjithësisht të pranuara të së drejtës ndërkombëtare dhe akteve të tjera të përgjithshme, të miratuara sipas ligjit (neni 144.1 i **KSerb**). Ndalohet çdo ndikim i pavend në ushtrimin e detyrës së gjyqtarit (neni 144.2 i **KSerb**).

Me **amendamentin VII** është zëvendësuar neni 145 i **KSerb**. Kushtet për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe kushtet për zgjedhje dhe mandat të gjyqtarëve porotë caktohen me ligj (neni 145 i **KSerb**).

Me **amendamentin VIII** është zëvendësuar neni 146 i **KSerb**. Funksioni i gjyqtarit është i përhershëm (neni 146.1 i **KSerb**). Ky funksion zgjat nga zgjedhja gjyqtar deri në plotësimin e kushteve për pension (neni 146.2 i **KSerb**). Gjyqtarit i ndërpritet funksioni para plotësimit të shekullit të punës (pensionit) në këto raste: nëse vetë kërkon një gjë të tillë, nëse përherë humb aftësinë për të ushtruar funksionin e gjyqtarit, nëse humb shtetësinë e Serbisë dhe nëse shkarkohet (neni 146.3 i **KSerb**). Gjyqtari shkarkohet nëse dënohet për vepër penale me dënim prej së paku gjashtë muaj apo nëse në procedurë disiplinore vërtetohet se ka bërë shkelje të rënd disiplinore, sipas vlerësimit të KLGJSerb (neni 146.4 i **KSerb**). Vendimin për ndërprerjen e funksionit të gjyqtarit e merr **KLGJSerb** (neni 146.5 i **KSerb**). Kundër vendimit për ndërprerje të funksionit të gjyqtarit, gjyqtari mund të ushtroj ankesë në GJKSerb, e cila përjashton të drejtën për ankesë kushtetuese (neni 146.6 i **KSerb**).

Me **amendamentin IX është zëvendësuar neni 147 i KSerb**. Gjyqtari ka të drejtë që funksionin e gjyqtarit ta ushtroj në gjykatën ku është zgjedhur dhe vetëm me pëlqimin e vet mund të transferohet përherë ose të dërgohet përkohësisht në një gjykatë tjetër, përjashtim kushteve të përcaktuara me KSerb (neni 147.1 i **KSerb**). Në rastet e suprimimit të gjykatës, gjyqtari transferohet në gjykatën e cila merr kompetencat e gjykatës së suprimuar (neni 147.2 i **KSerb**). Në rastet e suprimimit të pjesës më të madhe të kompetencës së gjykatës, gjyqtari mund, përjashtimisht, pa vullnetin e vet, të transferohet përherë ose të dërgohet përkohësisht në gjykatën tjetër të shkallës së njëjtë që ka marrë pjesën më të madhe të kompetencave (neni 147.3 i **KSerb**). Gjyqtari që është transferuar përherë ose është dërguar përkohësisht në gjykatën tjetër ka të drejtë të mbaj rrogën që ka pasur në gjykatën nga ku është transferuar ose dërguar, nëse ajo është më e favorshme për të (neni 147.4 i **KSerb**). Gjykatës i suprimohen pjesa dërrmuese e kompetencave nëse shkaku i ndryshimit të kompetencës lëndore, themelimit të gjykatës së re ose për shkaqe të tjera të përcaktuara me ligj zvogëlohet numri i gjyqtarëve në gjykatë (neni 147.5 i **KSerb**). Kundër vendimit mbi transferim ose dërgim të përkohshëm, gjyqtari ka të drejtë në ankesë në GJKSerb, e cila përjashton të drejtën në ankesë kushtetuese (neni 147.6 i **KSerb**).

Me **amendamentin X është zëvendësuar neni 148 i KSerb**. Gjyqtari nuk mund të thirret në përgjegjësi për mendimin e dhënë lidhur me ushtrimin e funksionit të gjyqtarit dhe për votim me rastin e marrjes së vendimit, Përveç nëse kryen vepër penale të shkeljes së ligjit nga ana e vetë gjyqtarit ose prokurorit publik (neni 148.1 i **KSerb**). Pa lejen e KLGJSerb, gjyqtari nuk mund të privohet nga liria në procedurën e nisur për vepër penale të kryer gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit (neni 148.2 i **KSerb**). Me ligj rregullohet cilat funksione, punë ose interesa privat janë të papajtueshëm me funksionin e gjyqtarit dhe gjyqtarit porot (neni 148.3 i **KSerb**). Ndalohet veprimtaria politike e gjyqtarëve (neni 148.4 i **KSerb**).

Me **amendamentin X është zëvendësuar neni 149 i KSerb**. Kryetarin e GJSSerb e zgjedh KLGJSerb, pas marrjes së mendimit të Seancës së Përgjithshme të GJSSerb, me mandat pesë vite (neni 149.1 i **KSerb**). I njëjti person nuk mund të zgjidhet sërish për kryetar të GJSSerb (neni 149.2 i **KSerb**). Kryetarët e gjykatave të tjera i zgjedh KLGJSerb, për pesë vite (nenei 149.3 i **KSerb**).

Me **amendamentin XII është zëvendësuar neni 150 i KSerb**. **KLGJSerb është organ shtetëror që siguron dhe garanton pavarësinë e gjyqeve, gjyqtarëve, kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve porot (neni 150.1 i KSerb**). Ky organ zgjedh gjyqtarët dhe gjyqtarët porotë dhe vendos për ndërprerjen e funksionit të tyre, zgjedh kryetarin e GJSSerb dhe kryetarët e gjykatave të tjera dhe vendos për ndërprerjen e

funksionit të tyre, vendos për transferin dhe dërgimin e gjyqtarëve, cakton numrin e nevojshëm të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë, vendos për çështje të tjera lidhur me pozitën e gjyqtarëve, kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve porotë dhe kryen kompetenca të tjera të rregulluara me KSerb dhe ligj (neni 150.2 i **KSerb**).

Me **amendamentin XIII është zëvendësuar neni 151 i KSerb**. KLGJSerb e përbëjnë 11 anëtarë: gjashtë gjyqtarë që i zgjedhin vetë gjyqtarët, katër juristë të dalluar që i zgjedh Kuvendi dhe kryetari GJSSerb (neni 151.1 i **KSerb**). Zgjedhja e anëtarëve të KLGJSerb nga radha e gjyqtarëve rregullohet me ligj (neni 151.2 i **KSerb**). Me rastin e zgjedhjes së gjyqtarëve në KLGJSerb merret parasysh përfaqësimi sa më i gjerë i krejt gjyqësorit (neni 151.3 i **KSerb**). Kuvendi zgjedh anëtarët e KLGJSerb nga radha e juristëve të dalluar më së paku dhjetë vite përvojë punë në profesion, nga tetë anëtarët që i propozon Kuvendi Serbisë, pas konkursit publik, me votat e dy të tretave të krejt deputetëve, sipas ligjit (neni 151.4. i **KSerb**). Nëse Kuvendi nuk zgjedh katër anëtarët në afatin e përcaktuar ligjor, anëtarët tjerë i zgjedh një komision që përbëhet nga kryetari Kuvendit, kryetari GJKSerb, kryetari GJSSerb, kryeprokurori Serbisë dhe Avokati Popullit, me shumicë votash (neni 151.5 i **KSerb**). Kryetarët e gjykatave nuk mund të zgjidhen në KLGJSerb (neni 151.6 i **KSerb**). Anëtarët e KLGJSerb nuk mund të provohen nga liria pa lejen e këtij organi në procedurën e nisur për shkak të veprës penale që kanë kryer si anëtarë të KLGJSerb (neni 151.7 i **KSerb**).

Me **amendamentin XVII është shtuar neni ri mbi nenin ekzistues 155 të KSerb që ka bërë fjalë për mjetin juridik. Tani është kapitull i ri nr. 8 (**"Prokuroritë Publike" dhe ka këtë përmbajtje: Prokuroria publike është organ shtetëror unik dhe i pavarur, i cili ndjek kryesit e veprave penale dhe veprave të tjera dhe kryen edhe veprimtari të tjera nga kompetencat me të cilat mbrohet interesi publik, sipas ligjit (neni 155.1 i **KSerb**); Prokuroria publike ushtron kompetencat e saj në bazë të KSerb, marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, ligjeve, rregullave përgjithësisht të pranuara të së drejtës ndërkombëtare dhe akteve të tjera juridike, të nxjerra në bazë të ligjit (neni 155.2 i **KSerb**); Askush jashtë prokurorisë nuk mund të ndikoj në prokurorinë publike dhe bartësit e funksionit të organit të akuzës sa i përket procedurës dhe vendimmarrjes në rastet konkrete (neni 151.3 i **KSerb**); Themelimi, suprimimi, organizimi dhe kompetencat e prokurorisë publike rregullohet me ligj (neni 151.4 i **KSerb**); Prokuroria më e lartë publike në Republikën e Serbisë është **Prokuroria supreme publike** (PSPSerb), me të cilën udhëheq prokurori suprem publik (Kryeprokurori) (neni 151.5 i **KSerb**); Funksionin e prokurorit publik i kryejnë prokurori suprem publik (Kryeprokurori), prokurori kryesor publik dhe prokurorët publikë (neni 151.6 i **KSerb**); Prokurori suprem publik (Kryeprokurori) dhe prokurori kryesor publik në udhëheqjen me prokuroritë publike kanë autorizime hierarkike në raport me veprimin e prokurorive më të ulëta publike dhe prokurorëve publik në lëndët konkrete (neni 151.7 i **KSerb**); Autorizimet hierarkike dhe mjetet juridike kundër tyre më afër rregullohen me ligj (neni 151.8 i **KSerb**).

Me **amendamentin XVIII** emri për kapitullin e 9 dhe shenja e tij janë ndryshuar me emrin e nenit 156 kurse neni 156 i **KSerb zëvendësohet me emrin** "Përgjegjësia" dhe duket si vijon: Prokurori suprem publik (kryeprokurori) përgjigjet për punën e tij dhe për punën e prokurorisë para Kuvendit. Ajo/ai nuk përgjigjet para Kuvendit për veprim ndaj rastit (lëndës) konkrete (neni 156.1 i **KSerb**). Prokurori kryesor publik përgjigjet për punën e prokurorisë publike dhe për punën e vet Prokurorit suprem publik (kryeprokurorit) dhe drejtpërdrejtë prokurorit më të lartë publik, sipas ligjit (neni 156.2 i **KSerb**).Prokurorët publikë përgjigjen për punën e tyre prokurorit publik kryesor, sipas ligjit (neni 156.3 i **KSerb**).

Me **amendamentin XIX është zëvendësuar neni 157 dhe emërtimi i tij në KSerb**. Prokurori suprem publik (Kryeprokurori) nxjerr udhëzime të përgjithshme të detyrueshme për veprim të prokurorëve kryesor publikë me qëllim të arritjes së ligjshmërisë, efektivitet dhe njëjtësisë në punë (neni 157.1 i **KSerb**). Prokurori i drejtpërdrejtë publik më i lartë mund të nxjerr udhëzime të detyrueshme për veprim konkret në një lëndë për prokurorin publik më të ulët, nëse ekziston dyshimi në efikasitetin apo ligjshmërinë e veprimit. Prokurori suprem publik (Kryeprokurori), një udhëzim të tillë mund ta lëshoj për secilin prokuror publik (neni 157.2 i **KSerb**). Prokurori publik kryesor mund të nxjerr udhëzime të detyrueshme për veprim konkret prokurorit tjetër publik nën te (neni 157.3 i **KSerb**). Prokurori krye-

sor publik dhe prokurorët publik kanë detyrim të veprojnë sipas udhëzimit (neni 157.4 i **KSerb**). Prokurori më i ulët publik ose prokurori publik që konsideron se udhëzimi i detyrueshëm është joligjor ose i pabazë ka të drejtë në prapësim, sipas ligjit (neni 157.5 i **KSerb**).

Me **amendamentin XX është zëvendësuar neni 158 dhe emërtimi i tij në KSerb**. Me këtë amendament normohet zgjedhja dhe ndërprerja e funksionit të prokurorit suprem publik dhe prokurorit kryesor. Organi emërues është Kuvendi, për pesë vite, me propozimin e **Këshillit të Lartë Prokurorial** (KLPSerb), me votat e tri të pestave të deputetëve, sipas ligjit (neni 158.1 i **KSerb**). Në paragrafët tjerë përcaktohet procedura e kandidimit deri në zgjedhje: **KLPSerb** propozon vetëm një kandidat për prokuror suprem (Kryeprokuror) (neni 158.2 i **KSerb**). Nëse Kuvendi nuk zgjedh prokurorin suprem publik në afatin e përcaktuar, pas kalimit të dhjetë ditëve, atëherë atë e zgjedh, në mesin e krejt kandidatëve që plotësojnë kushtet për zgjedhje, një komision që përbëhet nga presidenti i Kuvendit, presidenti GJKSerb, presidenti GJSSerb, prokurori suprem publik dhe Avokati Popullit, më shumicë të votave (neni 158.3 i **KSerb**). Personi njëjtë nuk mund të rizgjidhet sërish për pozitën e prokurorit suprem publik/Kryeprokurorit (neni 158.4 i **KSerb**). Prokurorin kryesor e zgjedh **KLPSerb**, për gjashtë vite (neni 158.5 i i **KSerb**). Para kalimit të kohës për të cilën është zgjedhur, prokurorit suprem publik (kryeprokurorit) funksioni mund t'i ndërpritet: nëse vetë kërkon, nëse suprimohet prokuroria publike, nëse përherë humb aftësinë për kryerjen e funksionit të prokurorit publik, nëse humb shtetësinë e Republikës së Serbisë ose shkarkohet (neni 158.6 i **KSerb**). Prokurori suprem publik (Kryeprokurori) dhe prokurori kryesor shkarkohen nëse dënohen për vepër penale me dënim më burg më së paku prej gjashtë muajve ose nëse shfaqet ndonjë arsye e përcaktuar me ligj për shkarkim (neni 158.7 i **KSerb**). Kundër vendimit të KLPSerb mbi ndërprerjen e funksionit, prokurori kryesor publik ka të drejtë ankese në GJKSerb, e cila përjashton ankesën kushtetuese (neni 158.8 i **KSerb**). Prokurori suprem publik (Kryeprokurori) dhe prokurori kryesor të cilëve iu ndërpritet funksioni ngelin në detyrë, sipas ligjit (neni 158.9 i **KSerb**).

Me **amendamentin XXI është zëvendësuar neni 159 dhe emërtimi i tij në KSerb**. Me të normohen kushtet për zgjedhjen e prokurorit kryesor publik dhe prokurorit publik. Ka vetëm një dispozitë dhe përcakton se kushtet si më sipër caktohen me ligj. Me **amendamentin XXII është zëvendësuar neni 160 dhe emërtimi i tij në KSerb**. Me këtë amendament përcaktohet natyra e funksionit të prokurorit publik, si një funksion permanent. Funksioni i prokurorit publik është permanent (neni 160.1 i **KSerb**). Para mbushjes së shekullit të punës, prokurorit publik i ndërpritet funksioni: nëse vetë kërkon, nëse përherë humb aftësinë për ushtrimin e funksionit të prokurorit publik, nëse humb shtetësinë e Republikës së Serbisë, ose nëse shkarkohet (neni 160.2 i **KSerb**). Prokurori publik shkarkohet nëse dënohet për vepër penale me dënim me burg së paku gjashtë vite apo nëse në procedurë disiplinore konstatohet se ka kryer kundërvajtje të rëndë disiplinore, e cila, sipas vlerësimit të KLPSerb, dëmton rëndë autoritetin e prokurorisë publike ose besimin e publikut në t**ë** (neni 160.3 i **KSerb**).Vendimi për ndërprerjen e funksionit të prokurorit publik e merr KLPSerb (neni 160.4 i i **KSerb**). Kundër vendimit për ndërprerje të funksionit të KLPSerb, prokurori publik ka të drejtë ankese në GJKSerb, e cila përjashton të drejtën në ankesë kushtetuese (neni 160.5 i **KSerb**).

Me **amendamentin XXIII është zëvendësuar neni 161 dhe emërtimi i tij në KSerb** dhe ka të bëj me imunitetin dhe papajtueshmërinë e funksionit të prokurorit me funksionet, punët dhe profesionet tjera. Prokurori suprem publik (Kryeprokurori), prokurori publik kryesor dhe prokurori publik nuk mund të thirren në përgjegjësi për mendimin e dhënë ose vendimin e nxjerrë gjatë kryerjes së funksionit, përveç kur kryejnë vepër penale të shkeljes së ligjit nga ana e gjyqtarit ose prokurorit publik (neni 161.1 i **KSerb**). Prokurori suprem publik, prokurori kryesor publik dhe prokurori publik nuk mund të privohen nga liria pa lejen e KLPSerb, për sa i përket procedurës për shkak të veprës penale të kryer gjatë ushtrimit të funksionit të tyre (neni 161.2 i **KSerb**). Me ligj përcaktohet cilat funksione, punë ose interesa privat janë të papajtueshëm me funksionin e prokurorit suprem publik (Kryeprokurorit), prokurorit kryesor dhe prokurorit publik (neni 161.3 i **KSerb**).

Me **amendamentin XXIII është zëvendësuar neni 162 dhe emërtimi i tij në KSerb** dhe ka të bëj me KLPSerb. Ky është një organ i pavarur shtetëror, që siguron pavarësinë e prokurorisë publike, prokurorit suprem publik, prokurorëve kryesorë dhe prokurorëve publikë (neni 162.1 i **KSerb**). KLPSerb i propozon Kuvendit zgjedhjen dhe ndërprerjen e funksionit të prokurorit suprem publik, emëron ushtruesin e detyrës së funksionit të prokurorit suprem publik, zgjedh prokurorët kryesorë dhe prokurorët publikë dhe vendos për ndërprerjen e funksionit të tyre, vendos për çështje të tjera lidhur me pozitën e prokurorit suprem publik, prokurorëve kryesorë publikë dhe prokurorëve publikë dhe kryen punë të tjera të caktuara me KSerb dhe ligj (neni 162.2 i **KSerb**). Me **amendamentin XXIII është zëvendësuar neni 163 dhe emërtimi i tij në KSerb** dhe ka të bëj me përbërjen e KLPSerb. Ky organ përbëhet nga 11 anëtarë: pesë prokurorë publikë që zgjidhen nga prokurorët publikë kryesorë dhe prokurorët publikë, katër juristë të njohur që i zgjedh Kuvendi, prokurori suprem publik (Kryeprokurori) dhe ministri kompetent për drejtësi (neni 163.1 i **KSerb**). Ky i fundit nuk voton në procedurën për caktimin e përgjegjësisë disiplinore të prokurorit publik (neni 163.2 i **KSerb**). Zgjedhja e anëtarëve të KLPSerb nga radha e prokurorëve publikë rregullohet me ligj (neni 163.3 i **KSerb**). Me rastin e zgjedhjes së prokurorëve publikë në KLPSerb i kushtohet kujdes përfaqësimit sa më të gjerë të prokurorëve publikë (neni 163.4 i **KSerb**). Kuvendi zgjedh katër anëtarët e KLPSerb nga mesi juristëve të njohur më së pakur dhjetë vite përvojë pune në profesion, pas konkursit të hapur, me votat e dy të tretave të deputetëve, sipas ligjit (neni 163.5 i **KSerb**). Nëse Kuvendi nuk i zgjedh katër anëtarët në afatin e përcaktuar, të tjerët, pas kalimit të afatit, zgjidhen nga mesi kandidatëve që plotësojnë kushtet për zgjedhje nga një komision që përbëhet nga kryetari Kuvendit, kryetari GJKSerb, kryetari GJSSerb, prokurori suprem publik (Kryeprokurori) dhe Avokati Popullit, me shumicë votash (neni 163.6 i **KSerb**). Prokurori kryesor publik nuk mund të zgjidhet në KLPSerb (neni 163.7 i **KSerb**). Anëtari KLPSerb që është zgjedhur nga Kuvendi duhet të jetë i denjë për funksionin (neni 163.8 i **KSerb**) dhe nuk mund të jetë anëtar partisë politike (neni 168.9 i **KSerb**). Kushtet tjera për zgjedhje dhe papajtueshmërinë me funksionin e anëtarit të KLPSerb që zgjidhen nga Kuvendi i përcakton ligji (neni 163.10 i **KSerb**).

Me **amendamentin XXVI është zëvendësuar neni 164 dhe emërtimi i tij në KSerb** dhe ka të bëj me mandatin e anëtarëve të KLPSerb, kryetarin dhe nënkryetarin e këtij organi. Anëtari KLPSerb zgjidhet për pesë vite (neni 164.1 i **KSerb**). Personi njëjtë nuk mund të rizgjidhet në KLPSerb (neni 164.2 i **KSerb**). KLPSerb ka kryetarin dhe nënkryetarin (neni 164.3 i **KSerb**). Kryetari zgjidhet nga radhët e KLPSerb që janë prokurorë publikë, kurse nënkryetarin nga radhët e anëtarëve nga Kuvendi, për pesë vite (neni 164.4 i **KSerb**). Para skadimit të kohës për të cilën janë zgjedhur, anëtarit të KLPSerb i ndërpritet mandati nëse vetë kërkon një gjë të tillë ose nëse dënohet për vepër penale me dënim më burg më së paku prej gjashtë muajve. Anëtari që është prokuror publik e humb mandatin me ndërprerjen e funksionit të prokurorit publik, kurse anëtarit që nuk është prokuror, nëse humb përherë aftësinë për të ushtruar funksionin e anëtarit të KLPSerb (neni 164.5 i **KSerb**). Vendimin për ndërprerjen e mandatit të anëtarit të KLPSerb e merr KLPSerb. Kundër vendimit në fjalë mund të paraqitet ankesë në GJKSerb, e cila përjashton të drejtën për ankesë kushtetuese (neni 164.6 i **KSerb**).

Me **amendamentin XXVII është zëvendësuar neni 165 dhe emërtimi i tij në KSerb**, ka të bëj me ankesën kundër vendimit të KLPSerb dhe ka vetëm një paragraf që thotë si vijon: Kundër vendimit të KLPSerb lejohet ankesa GJKSerb, sipas KSerb dhe ligjit. Ankesa përjashton të drejtën e parashtrimit të ankesës kushtetuese në GJKSerb. Me **amendamentin XXVIII** shtohet një nen i ri në **KSerb**, neni 165a, dhe ka të bëj me imunitetin e anëtarëve të KLPSerb. Anëtarët e KLPSerb nuk mund të thirren në përgjegjësi për mendimin e dhënë lidhur me ushtrimin e funksionit të anëtarit të KLPSerb dhe për votim me rastin e miratimit të vendimeve të këtij organi (neni 165a, parag. 1 i **KSerb**). Anëtari i KLPSerb nuk mund të privohen nga liria pa lejen e **KLPSerb**, lidhur me procedurën, për shkak të veprës penale që e kanë kryer si anëtar i **KLPSerb.**

26. Gjyqësia kushtetuese: funksioni dhe sistemet

Parimi i ndarjes së pushtetit shtetëror në tri degë është gurëthemel i sistemeve kushtetuese në shtetet bashkëkohore. Në shumicën prej tyre, megjithatë, ndarja trepalëshe është zgjeruar edhe me një funksion shtetëror, të cilin e ushtron një organ i posaçëm ose gjykatat e rregullta ekzistuese. Fjala është për funksionin e gjyqësisë kushtetuese, përmes së cilës gjykata kushtetuese, ose gjykata e rregullt e veshur me juridiksionin e gjyqësisë kushtetuese, kujdeset që ligji, aktet, veprimet dhe lëshimet tjera të jenë në pajtim me kushtetutën. Funksioni i gjyqësisë kushtetuese ka mundësi që përmes kontrollimit të ligjeve, akteve, veprimeve dhe mospevrimeve të autoriteteve publike të ndikoj në punën e pushteteve të tjera: pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Përveç kontrollit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, gjyqësia kushtetuese kryen edhe detyra të tjera.

Për realizimin e sundimit të së drejtës, funksionimi i gjyqësisë kushtetuese është vendimtare. Me ndihmën e saj, pushteti ligjvënës dhe ekzekutiv, por edhe ai gjyqësor, mbahen brenda kufijve të kushtetutës dhe provohet epërsia e shtetit të së drejtës. Përmes kontrollit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, gjyqësia kushtetuese në thelb arbitron në mosmarrëveshjet mes tri pushteteve, veçanërisht mes pushteteve politike, – ligjvënësit dhe ekzekutivit -, duke i vënë të njëjtat brenda parametrave kushtetues. Pa një mbrojtës të tillë, kushtetuta do të lihej në mëshirën e politikës, e cila do të miratonte akte, ndërmerrte veprime, lëshonte marrjen e veprimeve sipas tekeve të politikës ditore. Sistemi juridik dhe hierarkia e tij, me në krye kushtetutën, do të ishin shkatërruar, kurse liritë dhe të drejtat njerëzore në një regjim të tillë do të ishin rrënuar dhe lënë në mëshirë të vullnetit të pakufiziuar politik.[224]

Veçantia e funksionit të gjyqësisë kushtetuese qëndron në atë se ajo zbaton jo vetëm kriteret juridike por edhe ato politike me rastin e zgjidhjes së një kontesti (fillimisht) juridik, siç është çështja e pajtueshmërisë së ligjit, akteve dhe veprimeve të tjera e mosveprimeve me kushtetutën. Një gjë e tillë nënkupton që, përveç krahasimit të kushtetutshmërisë së veprimit ose mosveprimit shtetëror, përkatësisht përveç përcaktimit të domethënies normative të këtyre veprimeve dhe mosveprimeve, me rastin e zgjedhjes së një mosmarrëveshjeje kushtetuese merret parasysh edhe konteksti i gjerë politik, ta zëmë: çfarë synohet të arrihet me ligj ose aktin tjetër juridik objekt kontrolli, ose me mosveprim të autoriteteve publike, cila është ideologjia dominuese e kohës, cilat janë qëllimet, synimet dhe parimet kushtetuese. Kjo nënkupton që me funksionin e gjyqësisë kushtetuese zgjidhet një mosmarrëveshje kushtetuese, por jo me anë të gjykimit si të tillë, por përmes një veprimtarie të posaçme për të cilën vlejnë rregulla të posaçme.

Qëllimi themelor i funksionit të gjyqësisë kushtetuese është që të mbahet veprimtaria e organeve shtetërore dhe autoriteteve publike brenda kufijve të kushtetutës dhe parametrave të saj dhe, rrjedhimisht, të kthej veprimtarinë e tyre prapa në universin e përcaktuar nga kushtetuta kur ata kalojnë kufijtë e këtij universi. Kjo nënkupton, praktikisht, që funksion primar i gjyqësisë kushtetuese është sendërtimi i kushtetutës dhe sigurimi i epërsisë së saj. Në praktikë kjo shihet, ta zëmë, te rasti kur ligji, dekreti, ose pjesë të tyre, anulohen ose shfuqizohen. Me eliminimin e tyre nga rendi juridik, gjykata kushtetuese (ose gjykata tjetër e rregullt e veshur me juridiksionin e gjyqësisë kushtetuese), praktikisht depërton në kompetencat e ligjvënësit dhe organeve të tjera shtetërore dhe autoriteteve publike. Kur bëhet fjalë për ligjvënësin, mbrojtësi i kushtetutës ndërhyn vetëm si një **ligjvënës negativ**, siç e ka thënë **Hans Kelsen**. Në një ese të tij famoze në vitin 1928, ky autor ka definuar gjykatën kushtetuese si ”ligjvënëse negative”. Sipas tij, vendimi i gjykatës kushtetuese për të anuluar një dispozitë ligjore për shkak të papajtueshmërisë së tyre me kushtetutën bëhet duke ndjekur procedurën gjyqësore. Por, në fakt, anulimi ka efekt të **ligjvënësit negativ**, për shkak se modifikon ligjin në fuqi brenda rendit juridik, duke hequr nga ai dispozitat e shpallura si jokushtetuese. [225] Me këtë veprim, gjykata kushtetuese nuk rrënon pushtetin

[224] Më shumë për gjyqësinë kushtetuese si veprimtari shtetërore që ka për synim sigurimin e supremacisë së kushtetutës, si në aspektin historik ashtu edhe në aspektin krahasimor, cf. në Enver Hasani & Muhamet Brahimi, *Gjyqësia kushtetuese*, fq. 21-81.

[225] Cf. Hans Kelsen, “La garantie juridictionnelle de la constitution (la justice constitutionnelle)”. *Revue du droit public et*

legjislativ. Përkundrazi, atij ia rikthen autoritetin pas nxjerrjes së një ligji që ka përmbajtur dispozita jokushtetuese.

Që gjyqësia kushtetuese të mbroj kushtetutën nga aktet juridike, veprimet ose mosveprimet e pushtetit dhe autoriteteve të tjera publike, atëherë duhet të ndërtohet një autoritet i tillë nga ana e organit që ushtron këtë funksion, i tillë që pushtetet tjera dhe opinioni publik e pranojnë duke vënë në jetë vendimet e tij. Kjo është një prej kushteve thelbësore për sundim të së drejtës. N**ë** shtetet ku nuk kultivohet parimi ndarjes së pushtetit dhe institucionet kushtetuese nuk janë të ndërtuara, organet tjera nuk kanë vullnet për të pranuar vendimet e gjyqësisë kushtetuese. Në këto raste, gjyqësia kushtetuese është pa autoritet dhe nuk mund të mbroj kushtetutën.

Ekzistojnë **tri sisteme** të gjyqësisë kushtetuese, të modeluara në mënyra të ndryshme, në vartësi të asaj se cili organ ka juridiksion për zgjidhje të kontesteve kushtetuese. Sistemi më i vjetër i gjyqësisë kushtetuese është ai në të cilin kontestet kushtetuese i zgjedhin gjykatat e rregullta (Australia, SHBA-ja, Kanadaja). Këtu veprimtaria e gjyqësisë kushtetuese ndodhet në duart e pushtetit gjyqësor, pra organikisht nuk përfaqëson një funksion të veçantë. Gjykatat e rregullta, të zakonshme, vendosin për kontestin kushtetues, i cili dallon nga gjykimi klasik bazuar në rregullat e posaçme të procedurës dhe kriteret sipas të cilave zgjidhet kontesti në fjalë. Ky model ka lindur në SHBA, përkundër që kontrolli gjyqësor i kushtetutshmërisë së ligjeve ("judicial review") nuk njihet me **Kushtetutën e SHBA-së**. **GJSAm** përmes interpretimit gjyqësor në këtë rast, ka përvetësuar për vete të drejtën e kontrollit kushtetues të akteve juridike, veprimeve dhe mosveprimeve të organeve të tjera të pushtetit, në një kohë që vetë është në krye të njërit prej tyre – pushtetit gjyqësor.

Fillimi i gjyqësisë kushtetuese lidhet me rastin e parë dhe më të njohur të kontestit kushtetues, rasti **Marbury kundër Madisonit** (1803). Në këtë rast është dhënë përgjigjja në pyetjen kruciale për krejt sistemin e gjyqësisë kushtetuese. Vendimi personifikohet me kryetarin e **GJSAm** në kohën e marrjes së vendimit, Gjon Marshal (John Marshall: 1755-1835), i cili ka qenë kryetari i katërt me radhë i instancës më të lartë gjyqësore amerikane.[226] Pyetja në rastin si më sipër ka qenë kjo: a është kushtetuta ligji që për nga fuqia juridike qëndron mbi të gjitha ligjet tjera? Nëse ky është rasti, pra që kushtetuta është ligji më i lartë në vend, atëherë rrjedh përfundimi se ligjet nuk mund të ndryshojnë kushtetutën, por duhet të jenë në pajtim me të, në aspektin material dhe formal. Në të kundërtën, ato do të mënjanohen nga rendi juridik. Sikur të ishte pranuar qëndrimi se kushtetuta është e njëjtë me ligjin, atëherë ajo do të ishte ndryshuar me ligje dhe nuk do të kishte qenë digë kundër prodhimit nga pushtetet tjera të ligjeve sipas dëshirës. Do të krijohej një pushtet i pakontrolluar, por legal. Gjyqësia kushtetuese është krijuar në bazë të supozimit themelor që kushtetuta është akti më i lartë juridik dhe që nuk mund të ndryshohet me ligj. Në sistemin amerikan, GJSAm ka të drejtë të vlerësoj edhe kushtetutshmërinë e vendimeve të të gjitha gjykatave. Gjykatat tjera, në nivel të shteteve anëtare dhe të vetë shtetit, gjithashtu mund të ushtrojnë kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjera juridike, në disa juridiksione edhe të veprimeve dhe mosveprimeve të tjera të autoriteteve publike, brenda juridiksionit të tyre.

Sistemi i dytë është më i ri për një shekull të tërë. Në të ekziston një organ i ndarë dhe me juridiksion të posaçëm të përcaktuar në kushtetutë për mbrojtjen e kushtetutshmërisë (dhe ligjshmërisë në disa

de Science Politique en France et à l' *Etranger* (RDP), 1928, tome 45, fq. 197-257.

226 Në fakt, vendimi i parë i kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë, në kuptimin e sotëm të kësaj fjale, si kontroll që ka për qëllim sigurimin e supremacisë së aktit ose rendit juridik të një natyre të caktuar, ka lidnur në Angli në rastin e njohur si Dr. **Bonham Case** (1603). Në këtë rast, një doktor kishte humbur licencën dhe ishte ndëshkuar për shkak se nuk kishte bërë regjistrimin e saj siç e kërkonte ligji anglez i kohës. Gjykata angleze në fund ka vendsur se Dr. **Bonham** kishte pasur të drejtë sepse e **drejta e përgjithshme** angleze ("common Law"), e cila nuk këkronte licencë për ushtrimin e profesionit të doktorit, kishte epërsi ndaj ligjit të shkruar të këtij vendi. Kjo nënkuptonte që **e drejta e përgjithshme** kishte epërsi, kurse gjykatat angleze, për pasojë, kishin detyrim për të siguruar këtë epërsi të kësaj të drejte ndaj ligjit të shkruar, të nxjerrur nga parlamenti. Cf. më shumë për këtë Enver Hasani & Muhamet Brahimi, *Gjyqësia kushtetuese*, fq. 21, 24, 34, 39-40, 44, 83, 549, 552-553, 575, 626, 694, 701.

vende). Këtu hyjnë shumica e vendeve të Evropës dhe një pjesë e vendeve të Amerikës Latine, Azisë dhe Afrikës. Mbi pajtueshmërinë e ligjeve dhe akteve të tjera juridike, veprimeve dhe mosveprimeve të autoriteteve publike, këtu nuk vendos gjykata e rregullt apo e zakonshme, por një organ i posaçëm, i cili, në emërtim figuron si gjykatë, mirëpo ka dallim të madh nga gjykata në kuptim klasik të fjalës. Ky sistem, i njohur si sistemi evropian/kelsenian i gjyqësisë kushtetues, ka lindur në vitin 1920 në **Austri** dhe për arkitekt ideor e ka juristin e mirënjohur dhe filozofin e së drejtës, **Hans Kelsen**. Në fakt, në aspektin formal, gjyqësia kushtetuese disa muaj më herët ka lindur në **Çekosllovaki**.[227] Premisa themelore mbi të cilën është ndërtuar gjyqësia kushtetuese ka qenë se mosmarrëveshjet apo kontestet kushtetuese janë të ndryshme nga kontestet apo mosmarrëveshjet gjyqësore. Për pasojë, logjike dhe e drejtë është që një organ tjetër të ngarkohet me zgjedhjen e kontesteve kushtetuese, i ndryshëm nga gjyqësori i rregullt, mënyra dhe natyra e punës së tij. Fillimisht, nuk ka qenë kontrolli abstrakt i ligjeve arsyeja për krijimin e gjyqësisë kushtetuese: vetë **Gjykata Kushtetuese e Austrisë** (GJKAust), u pat krijuar me qëllim që, si një organ shtetëror që autorizimet e veta i nxjerr drejtpërdrejt nga kushtetuta, të mbroj shtetin austriak nga shkëputja eventuale e njësive federale, rishtazi të krijuara pas **Luftës së Parë Botërore**, mbi gërmadhat e ish-**Perandorisë Austro-Hungareze**. Mbrojtjen e tërësisë shtetërore dhe kushtetutës, **GJKAust** duhej ta bënte duke shpallur si jokushtetues aktet juridike spetaratiste. I njëjti **raison d'etre** ka qenë edhe prapa krijimit të **Gjykatës Kushtetuese të Çekosllovakisë** (GJK**Ç**ek). Më vonë, juridiksioni dhe kompetencat e këtyre dy gjykatave, si dhe të tjerave që erdhën pas tyre pas Luftës së Dytë Botërore, dukshëm janë zgjeruar. Në këtë kuptim ka pasur disa valë të përhapjes së gjyqësisë kushtetuese: vala e parë është ajo që ka ndodhur deri ne Luftën e Dytë Botërore. E dyta nis me themelimin e gjykatave kushtetuese në Gjermani dhe Itali dhe me rithemelimin e **GJKAust**. E treta fazë nis me vitet '80-të të shek. XX, kur u themeluan gjykatat kushtetuese në Portugali dhe Spanjë. Faza e katërt dhe e fundit ka nisur me rënien e komunizmit në vitin 1989 dhe deri më sot.

Sistemi i tretë i gjyqësisë kushtetuese ekziston në sistemin juridik-kushtetues francez, ku kjo gjyqësi është në duart e një organi jogjyqësor, i cili fare nuk cilësohet si gjykatë, por **Këshill Kushtetues** (KKFr). Ky organ qëndron edhe më larg të drejtës e më afër politikës, sesa gjykatat kushtetuese në sistemin evropian si më sipër. Kjo është kështu sepse anëtarët e **KKFr** ("Conseil constitutionnel") nuk kërkohet të jenë jurist dhe të kenë përvojën në jurisprudencë. Qëllim themelor i **KKFr** është të mbroj KFr nga aktet jokushtetuese dhe ta mbaj në kufijtë kushtetues veprimtarinë e legjislativit dhe ekzekutivit të vendit. Disa shtete kanë organin e njëjtë të gjyqësisë kushtetuese sipas modelit Francës (Algjeria, Tunizia, mirëpo këtu nëntë nga dymbëdhjetë anëtarët janë juristë; pastaj disa vende të Afrikës perëndimore dhe kështu me radhë.

26.1. Kushtetutshmëria dhe ligjshmëria dhe kontesti kushtetues

Në zgjedhjen e konfliktit mes ligjeve, përkatësisht akteve juridike kur ato rregullojnë ndryshe marrëdhëniet e njëjta juridike, vlejnë rregulla që për nga vjetërsia e tyre datojnë qysh nga koha romake. Nëse ligjet apo aktet juridike janë të fuqisë së njëjtë juridike, vlen ai që është krijuar më vonë (**lex posterior derogat lex priori**). Sipas një rregulli tjetër, konflikti ligjeve, përkatësisht mes akteve të tjera juridike zgjidhet ashtu që, vlen ligji apo akti special juridik para ligjit të përgjithshëm (**lex specialis derogat legis generali**). Themeli gjyqësisë kushtetuese në origjinë niset nga parimi që vlen akti juridik që ka vlerë apo fuqi më të madhe juridike kundrejt akteve të tjera.

Parakusht për kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë është ekzistimi i akteve të përgjithshme me fuqi të ndryshme juridike, të cilat janë në raport të hierarkisë mes tyre. Kjo nënkupton se në maje të hierarkisë gjendet një akt juridik që ka fuqi sipërore kundrejt akteve të tjera, të cilat duhet të jenë në pajtim me te.

[227] Në **Austri**, **Gjykata Kushtetuese** u formua me **Ligjin Kushtetues** të datës 1 tetor 1920 (ka hy në fuqi më 10 nëntor 1920), kurse **Gjykata Kushtetuese e Çekosllovaki** u formua më 29 shkurt 1920 me Kartën Kushtetuese të Çekosllovakisë. Përkundër që, në aspektin tekniko-juridik, del se në Çekosllovakia më herët është formuar organi i gjyqësisë kushtetuese, formimi i këtij organi për herë të parë ka nodhur në **Austri**, një vit para nxjerrjes së Ligjit Kushtetutes të datës 1 tetor 1920.

Ai akt quhet kushtetutë. Një sistematizim i tillë i akteve juridike e bën të veçantë sistemin juridik. Në kushtetutë zakonisht numërohen burimet e së drejtës dhe caktohet vendi i tyre në **hierarkinë e përgjithshme** brenda sistemit juridik. Ato burime janë: kushtetuta, ligjet kushtetuese, parimet dhe rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, marrëveshjet ndërkombëtare, ligjet organike, ligjet sistematike, ligjet, dekretet dhe urdhëresat, rregulloret, statutet dhe aktet tjera nënligjore. Si burime të së drejtës kushtetuese llogariten edhe vendimet, qëndrimet dhe mendimet e gjykatave kushtetuese dhe zakonet kushtetuese (konventat), por kushtetutat nuk përcaktojnë fuqinë e tyre juridike dhe as vendin në hierarkinë e sistemit juridik.

Kushtetutshmëria nënkupton që në sistemin juridik të gjitha aktet juridike me fuqi më të ulët juridike se kushtetuta duhet të jenë në pajtim me të. Për këtë përdoret formulimi: nuk guxojnë të jenë në kundërshtim me kushtetutën. **Ligjshmëria** nënkupton që të gjitha aktet juridike, të përgjithshme dhe individuale, me fuqi më të ulët se ligji, duhet të jenë në pajtim me të. Ato ku gjykata kushtetuese ka juridiksion edhe vlerësimin e ligjshmërisë, krahas vlerësimit të kushtetutshmërisë, atëherë ajo kujdeset për ligjshmërinë e akteve juridike, duke ushtruar **kontrollin e ligjshmërisë së akteve juridike individuale** në procedurën sipas **ankesës kushtetuese**, në ndërkohë që për **ligjshmërinë e akteve individuale** kujdesen gjykatat e rregullta.

Që një ligj të jetë në pajtim me kushtetutën, duhet të plotësohen **kushtet formale** dhe **materiale**. Kushti i parë formal është që ligji duhet të jetë nxjerr nga organi kompetent shtetëror. Ai është parlamenti nacional, organi përfaqësues i njësisë federale, regjionet ose krahinat, kurse në disa sisteme kushtetuese edhe qeveria gëzon të drejtën për nxjerrjen e ligjeve. E dyta, ligji duhet të prodhohet sipas mënyrës së përcaktuar juridike, që nënkupton se sjellja e ligjit paraqet një procedurë të formalizuar në tërësinë e vet. Kjo nënkupton që deri në prodhimin e tij duhet të ndiqen fazat e përcaktuara – propozimi, shqyrtimi, miratimi dhe shpallja e ligjit. Së fundi, ligji duhet të këtë formën e caktuar, formë në kuotimin e ngushtë të fjalës. Kjo nënkupton formën e shkruar, sistematizimin e ligjit në njësi më të vogla, nene, arsyetimin pse është nxjerr dhe me çfarë qëllimi.

Kushti material i kushtetutshmërisë së ligjit nënkupton se përmbajtja e ligjit duhet të jetë në pajtim me kushtetutën. Kjo nënkupton se me ligj nuk mund të rregullohet (normohet) ndryshe një çështje nga rregullimi (normimi) i bërë me kushtetutë për të njëjtën çështje; nuk mund të lejohet me ligj diçka që është e ndaluar me kushtetutë dhe anasjelltas; nuk mund të zvogëlohet vëllimi i të drejtave dhe lirive dhe garantuara me kushtetutë dhe as nuk mund të ashpërsohen kushtet për realizimin e të drejtave të përcaktuara si garancione me kushtetutë (ta zëmë, të drejtat zgjedhore, miratimi i ligjeve, zgjedhja në funksion gjyqësor dhe kështu me radhë: asnjëra nga kushtet e vëna me kushtetutë për realizimin e këtyre të drejtave dhe lirive nuk mund të ashpërsohen dhe ndryshohen me ligj). Ajo që lejohet dhe që, zakonisht, synohet me ligj, është saktësimi dhe përpunimi i dispozitës kushtetuese dhe mënyrës së zbatimit të saj.

Kuptimi i kushtetutshmërisë së ligjit ka edhe një kuptim tjetër, në **kuptimin politik**. Kjo nënkupton se ekziston një cilësi demokratike e ligjit. Në këtë kuptim të gjerë, ligji është në pajtim me kushtetutën vetëm atëherë kur, krahas kushtetutshmërisë formale dhe materiale, plotëson edhe kushtin demokratik, përkatësisht kur me të mbrohen dhe promovohen liritë dhe të drejtat e njeriut, sundimi i ligjit dhe shteti i së drejtës.

Kontrolli konkret i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë kërkon plotësimin e **disa kushteve**. Në rend të parë duhet të ekzistoj një rend juridik me **hierarki të akteve juridike**, me një kushtetutë të shkruar dhe të ngurtë në maje të akteve të rendit të tillë juridik, e cila në mënyrë të përgjithshme kodifikon materien kushtetuese. Kusht i dytë është që duhet të ekzistoj një organ i veshur me juridiksion të gjyqësisë kushtetuese, i cili ka fjalën përfundimtare në mënjanimin (heqjen) e akteve jokushtetuese nga rendi juridik, pra shërben si një lloj ”pastruesi i bërllokut juridik” brenda sistemit kushtetues. Në të vërtetë, për kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, këtë duhet thënë zëshëm, kujdesen dhe janë në ngarkesë

kushtetuese edhe organet që marrin pjesë në krijimin e dispozitave juridike – këshillat apo komisionet parlamentare, parlamenti, qeveria, shefi shtetit, mirëpo gjykimi dhe përfundimi i tyre lidhur me kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë nuk janë përfundimtare. Kusht i tretë është që me kushtetutë të garantohet dhe mbrohen **liritë dhe të drejtat e njeriut**, të cilat shërbejnë si kufizuese të pushtetit shtetëror. Nga tërë kjo rrjedh se realizimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë nuk është asgjë tjetër pos mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut, mbajtjen e politikës brenda kufijve të kushtetutës dhe ligjit. Ky është kuptimi më i saktë dhe më i përgjithshëm i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në botën bashkëkohore, sepse çdo gjë lidhet me kufizimin e pushtetit, gjë e cila ndodhë vetëm në vendet ku ekziston një korpus i gjallë dhe vibrant i lirive dhe të drejtave të njeriut me të cilat ndeshet pushteti politik në çdo hap të veprimtarisë së tij, ndeshje që ka një cak dhe fitues të fundit – individin. Kjo është arsyeja pse sot në kushtetutat bashkëkohore gjendet një kapitull apo pjesë e posaçme që i kushtohet lirive dhe të drejtave të njeriut, të cilat përshkojnë tërë mekanizimin e pushtetit politike dhe shërbejnë si një kufizues i tij në çdo hap dhe kohë. Çdo ushtrim i pushtetit kundër parametrave kushtetues e ligjorë mbi liritë dhe të drejtat e njeriut përbën ushtrim arbitrar i tij, uzurpim i pushtetit, format e manifestimit të të cilit janë të ndryshme (nga diktaturat brutale e deri te qeverisjet oligarkike pa fije skrupule për kufizimet normative të vëna nga kushtetuta e ligji).

Si shkak për kontrollin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë shërben **kontesti kushtetues**, një mosmarrëveshje e palëve lidhur me një objekt dhe vlerë kushtetuese. Në kuptimin më të gjerë dhe parë nga këndi i dogmatikës së pozitivizmit juridik të së drejtës kushtetuese, **kontesti kushtetues** është konflikt mes akteve juridike që lind nga shkaku i mospajtueshmërisë së ligjit ose aktit nënligjor me kushtetutën (**jokushtetutshmëria**) ose si pasojë e mospajtueshmërisë së aktit nënligjor me ligjin (**joligjshmëria**). Në një kuptim më të ngushtë, kontesti kushtetues përfshinë edhe mosmarrëveshjet mes individit dhe shtetit e çdo autoriteti tjetër publik sa i përket lirive dhe të drejtave kushtetuese, të cilat mund të shkelen nga shteti e autoritetet publike në përgjithësi me akte të karakterit të përgjithshëm por edhe me akte individuale (konkrete), të nxjerra në vijim të zbatimit të normave të përgjithshme juridike. Këtu bëhet fjalë vetëm për kontroll të kushtetutshmërisë (jokushtetutshmëria). Kjo për faktin se kontrolli i ligjshmërisë, kur ai kryhet nga gjykata kushtetuese, fokusohet vetëm në papajtueshmërinë e akteve të përgjithshme nënligjore me ligjin, kurse aktet joligjore individuale të autoriteteve publike i nënshtrohen kontrollit të ligjshmërisë përmes gjyqësisë së rregullt.

Nisur nga fakti se gjyqësia kushtetuese, në rend të parë përbën kontrollin kushtetues të akteve të pushteteve politike, legjislativit dhe ekzekutivit, kriteret mbi të cilat zgjidhet kontesti kushtetues janë **kritere juridike** dhe **kritere politike** në të njëjtën kohë. Në këtë mënyrë, mund të ndodhë që, një ligj jokushtetues nga aspekti formalo-juridik, gjykata kushtetuese ta lë në fuqi shkaku i rrethanave politike dhe nevojave pragmatike që lidhen me dobishmërinë e tij. Si shembull i kësaj mund të përmendet praktika e **GJSAm**, e cila zakonisht ka shmangur ndërhyrjet politike, mirëpo me aktivizmin e vet ka ndërtuar, krahas pozicionit juridik, edhe pozicion politik përkatës për çështjet konkrete të jetës publike amerikane (aborti, martesat e gjinisë së njëjtë, dënimi me vdekje, barazia racore etj). Kjo qasje bazohet në faktin që kontestet më të rënda dhe kryesore kushtetuese nuk është e mundur të ndahen nga kontestet politike. Objekt i kontrollit të kushtetutshmërisë janë aktet e organeve politike, pushtetit ligjvënës dhe ekzekutiv, ashtu që jo rrallë tërheq me vete politikën në natyrën e kontestin kushtetues.

Ekzistojnë **kontestet abstrakte** dhe **kontestet konkrete** lidhur me kushtetutshmërinë e akteve juridike, veprimeve dhe mosveprimeve të autoriteteve publike. Kontrolli abstrakt i kushtetutshmërisë nënkupton kontrollin **in abstracto** të normës juridike (kushtetuese, ligjore ose normës tjetër të përgjithshme), pa marrë parasysh nëse për atë normë ekziston ndonjë procedurë konkrete për testimin e zbatimit të saj në një rast ose mosmarrëveshje konkrete. Ekzistojnë subjektet e autorizuara kushtetuese për vënien në lëvizje para gjykatës kushtetuese të procedurës së kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës juridike. Nëse ligji shpallet jokushtetues, ai pushon së vlejturi. **Kontrolli konkret i kushtetutshmërisë** (kontrolli incidental i kushtetutshmërisë) lind lidhur me zbatimin konkret të normës juridike (ligjore dhe

tjetër) në një procedurë gjyqësore në gjykatat e rregullta. Nëse ekziston dyshimi që është jokushtetuese norma juridike, që duhet të zbatohet në një rast ose mosmarrëveshje konkrete që është në vijim e sipër në gjyqësorin e rregullt, atëherë gjykata e tillë fillon procedurën e vlerësimit të kushtetutshmërisë së normës konkrete që pritet të zbatohet me rastin e gjykimit dhe vendosjes së rastit ose mosmarrëveshjes konkrete. Nëse gjykata e njëjtë që gjykon dhe vendos rastin e shpall jokushtetues normën, siç ndodhë në **sistemin e decentralizuar të vlerësimit të kushtetutshmërisë**, atëherë ai vlerësim vlen vetëm për atë rast ose mosmarrëveshje konkrete që është gjykuar dhe vendosur. Kjo nënkupton se ngelë në fuqi ligji ose akti tjetër që ka përmbajtur normën e tillë që është vlerësuar si jokushtetuese për atë rast ose mosmarrëveshje të gjykuar dhe vendosur. Nëse lidhur me kushtetutshmërinë e normës së tillë vendos gjykata kushtetuese, siç ndodhë me **sistemin e centralizuar të vlerësimit të kushtetutshmërisë**, atëherë gjykata e rregullt që ka referuar për vlerësim të kushtetutshmërisë normën ndalon procedurën gjyqësore dhe pret vendimin e gjykatës kushtetuese. Në këtë rast, vendimi mbi jokushtetutshmërinë eliminon nga sistemi juridik ligjin jokushtetues ose ndonjë nen apo dispozitë të tij.

Kontrolli i mëpastajmë i kushtetutshmërisë së ligjit, i njohur si **kontrolli apo vlerësimi represiv i kushtetutshmërisë së ligjit**, paraqet një mekanizëm të rregullt dhe do të thotë se kushtetutshmëria e ligjit vlerësohet pas hyrjes së tij në fuqi. Këtu bëhet vlerësimi i kushtetutshmërisë së ligjit që tanimë ka hyrë në fuqi, por ka raste kur bëhet edhe vlerësimi i kushtetutshmërisë së ligjeve, apo pjesëve të tyre, që kanë pushuar së vlejturi. Në anën tjetër, **kontrolli apo vlerësimi paraprak i kushtetutshmërisë** ekziston atëherë kur gjykata kushtetuese ka autorizim për kontroll të kushtetutshmërisë së ligjit të miratuar në parlament, por që akoma nuk është shpallur dhe, për pasojë, nuk ka hyrë në fuqi. Në këtë mënyrë pengohet zbatimi i ligjit jokushtetues dhe prodhimi i pasojave juridike të dëmshme. Në disa vende mund të ushtrohet kontrolli kushtetues i marrëveshjeve të nënshkruara ndërkombëtare, para ratifikimit të tyre (Bullgaria, Spanja). Kjo nënkupton që palët kontraktuese duhet të tregojnë me kohë, gjatë lidhjes së marrëveshjes ndërkombëtare, për kufizimet kushtetuese që kanë në procesin e krijimit të detyrimeve kontraktuale ndërkombëtare. Aktualisht, vlen të theksohet, kushtetutat përcaktojnë kufizime kushtetuese, pa përjashtim, për marrëveshjet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me ngarkimin financiar të shtetit, borxhin, territorin, të drejtat dhe liritë e njeriut, aleancat dhe anëtarësimet në organizata ndërkombëtare dhe tema të ngjashme. Sipas të drejtës ndërkombëtare të traktateve, ndërkaq, kufizimet kushtetuese nuk mund të shërbejnë si bazë për anulim të detyrimeve të marra kontraktuale në planin ndërkombëtar. Ky është standard i të drejtës ndërkombëtare zakonore, i mishëruar edhe si standard edhe në **Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve** të vitit 1969 (ka hyrë në fuqi më 1980). Kontrolli preventiv **mund të jetë i detyrueshëm** për disa akte juridike, siç është rasti, ta zëmë, me **Francën** ku ekziston detyrimi për një gjë të tillë sa i përket ligjeve organike, disa propozim-ligje, rregulloret e dhomave të parlamentit. Në jo pak shtete, përfshirë Kosovën, ekziston edhe kontrolli ose vlerësimi preventiv i amendamenteve kushtetuese: ato nuk mund të hyjnë në fuqi pa dhënë mendimin e saj gardiani i kushtetutës. Vetëm atëherë mund të vij deri te hyrja e tyre në fuqi dhe zbatimi. Si parametër për vlerësim të kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese, i njohur ndryshe edhe si **doktrina mbi amendamentet jokushtetuese** (**unconstitutional constitutional amendments**), mund të shërbejnë pjesë të caktuara të kushtetutës, tërë kushtetuta, si dhe parimet, normat dhe përcaktimet tjera kushtetuese që gjenden jashtë tekstit bazik kushtetues (p.sh. anekset kushtetuese, marrëveshjet ndërkombëtare, tekstet e vjetra kushtetuese dhe kështu me radhë). Në të gjitha rastet si më sipër të kontrollit të detyrueshëm të kushtetutshmërisë së normave juridike (kushtetuese, ligjore dhe të tjera), gardiani i kushtetutës merr pjesë, praktikisht, në procedurën e kushtetutëbërëjes, ligjvënies dhe normavënies tjetër (**normavënësi pozitiv**).

E drejta e gardianit të kushtetutës për të kontrolluar aktet juridike, veprimet dhe mosveprimet e organeve të tjera publike ka qenë objekt i kontestimit. Një nga **postulatet e parlamentarizmit britanik** dhe në përgjithësi të **parlamentarizmit evropian** ka qenë dhe ngelet ai i pagabueshmërisë së ligjvënësit, i cili, për shkak të këtij postulati, nuk guxon të jetë i kufizuar. Ligji i parlamentit, thuhet në këtë postulat, është shprehje e vullnetit të përgjithshëm që aq shumë është i veshur me legjitimitet, sa nuk mund të jetë

kundër rregullave juridike. Më tutje theksohet se organet e pushtetit pa legjitimitet popullor anulojnë ligjet, siç është rasti me gardianin e kushtetutës, i cili kontrollon parlamentin që është një shprehje e sovranitetit dhe legjitimitetit popullor. Si argument i fundit i këtij postulati që konteston të drejtën e gardianit për kontroll të kushtetutshmërisë është ai që thotë se, për shkak të natyrës skajshmërisht abstrakte të normave kushtetuese, gardiani kushtetutës ka diskrecion dhe hapësirë tepër të madhe për vlerësim dhe, për pasojë, abuzim me pushtetin e kontrollit kushtetues të akteve juridike më të ulëta se kushtetuta, veprimeve dhe mosveprimeve të tjera të autoriteteve publike. Kjo nënkupton që, me fjalë të tjera, gjyqtarët kushtetuese çdo herë mund të gjejnë arsyetime përkatëse për shpalljen jokushtetuese të ligjeve që nuk iu pëlqejnë. Në këtë drejtim është e njohur thënia e një gjyqtari të **GJSAm**, **Xhon Harlan** (John Marshall Harlan: 1833-1911), i cili pat thënë se nuk kanë vështirësi të mëdha për të shpall jokushtetues një ligj të Kongresit amerikan, kur ai nuk iu pëlqen.[228] Në këtë mënyrë, pushteti i kontrollit (vlerësimit) të kushtetutshmërisë, në rastin kur atë e ushtrojnë funksionarët konservativ të pushtetit gjyqësor, mund të frenoj zhvillimin shoqëror dhe të heqin nga rendi juridik ligjet progresive. Kjo ka ndodhur në SHBA gjatë kohës së **Presidentit Ruzvelt** (Franklin Delano Roosevelt: 1881-1945), i cili pat qenë i detyruar të kërcënoj trupën gjyqësore të **GJSAm** me rritjen e numrit të tyre për të majorizuar konservativët në të, të cilët bllokonin reformën e nisur nga presidenti Ruzvelt.[229]

Nuk janë të pakët argumentet që shkojnë në favor të ekzistimit të pushtetit të gjyqësisë kushtetuese. Sikur mos të ekzistonte kontrolli kushtetutshmërisë, nuk do të realizohej cilësia e kushtetutës si akti më i lartë juridik – ajo do të konsiderohej një fiksion. Përmbajtja e kushtetutës nuk do të detyronte askënd, sepse nuk do të ekzistonte sanksioni ndaj shkeljes së saj – mënjanimi i aktit juridik, ndalimi veprimit ose mosveprimit të llojit të caktuar, për shkak të shkeljes (cenimit) së kushtetutës. Gjyqësia kushtetuese është një garancion shtesë përmes së cilës, krahas gjyqësisë së rregullt, sigurohet që shteti të mos bëhet pushtet i gjithëfuqishëm dhe i kudondodhshëm. Parlamenti është organi i sovranitetit popullor, por me përbërje laike, që nënkupton se ai herëdokur mund të nxjerr (dhe zakonisht nxjerr) ligje jokushtetuese, qoftë për shkak të padijes ose me qëllim të caktuar politik. E drejtë e gjyqësisë kushtetuese, që del nga kushtetuta, e cila ia garanton juridiksionin e plotë për kontroll kushtetues të akteve të caktuara juridike, veprimeve dhe mosveprimeve të natyrës së caktuar, ka të drejtë që të heq nga rendi juridik ligjin dhe çdo akt tjetër juridik që bie ndesh me kushtetutën, të ndaloj çdo veprim dhe urdhëroj veprim në rast të mosveprimit që shkel (cenon) aktin më të lartë juridik në vend.

Organi që ushtron gjyqësi kushtetuese, në kontestin kushtetues pranë tij bën interpretimin e kushtetutës. Në këtë mënyrë ai i jep kuptim të caktuar normës kushtetuese abstrakte, kushtetutën e bën më të afërt, më të kuptueshme dhe e përshtat ndaj rrethanave të reja shoqërore që krijohen me kalimin e kohës. Gjyqësia kushtetuese në veçanti është e dobishme dhe e domosdoshme në federata dhe formacione të tjera të shtetit të përbërë, ku duhet të zgjidhen kontestet dhe mosmarrëveshjes mes federatës, përkatësisht pushtetit qendror dhe njësive përbërëse të shtetit. Kjo ndihmon që shteti i përbërë të bëhet i tërë. Si një shembull i kundërt me këtë është rasti i **Zvicrës**, ku Gjykata Federale (**Bundesgericht**), si organ që ushtron gjyqësinë kushtetuese, ka një autorizim juridik-kushtetues mjaft të kufizuar në sferën e kontrollit të kushtetutshmërisë: ai nuk mund të vlerësoj kushtetutshmërinë e akteve të Parlamentit federal (**Bundesversammlung**) dhe të qeverisë (Qeverisë federale – **Bundesrat**).

26.2. Përbërja e organit të gjyqësisë kushtetuese

Përveç që janë të organizuar më ndryshe, përkatësisht si gjykata të rregullta, si organe jogjyqësore të posaçme dhe, së fundi, si gjykata kushtetuese, organet e gjyqësisë kushtetuese e kanë të ndryshme edhe

[228] Herbert W. Rice, "Book Review: Corwin: Constitutional Revolution, Ltd". *Marquete Law Review* Vol. 26 No. 2 (February 1942), 113-114. Në internet: http://scholarship.Law.marquette.edu/mulr/vol26/iss2/11 (shikuar më 12 dhjetor 2022).

[229] Cf. më shumë në Theresa A. Niedziela, "Franklin D. Roosevelt and the Supreme Court". *Presidential Studies Quarterly* Vol. 6 No. 4 (Fall, 1976), fq. 51-57.

përbërjen e tyre. Kjo përbërje diktohet nga modeli i caktimit të gjyqtarëve kushtetuese. Në këtë kuptim ekzistojnë tri modele. Modeli parë është ai model në të cilin caktimi i gjyqtarëve është i ndarë në mes të dy apo më shumë organeve, të cilat veprojnë ndaras dhe në mënyrë të pavarur nga njëri tjetri. Secili organ ka kuotat e veta të gjyqtarëve që duhet t'i caktojë, zakonisht çdo tre vjet. Ky ndryshe quhet edhe **modeli i caktimit të drejtpërdrejtë**. Në këtë model bëjnë pjesë **Austria, Bullgaria, Franca, Italia, Rumania, Spanja, Ukraina** etj.; Modeli i dytë është ai model në të cilin gjyqtarët caktohen ekskluzivisht me votën e parlamentit. Ky model njihet me emrin **modeli i zgjedhjes**. Ekziston në **Gjermani** dhe në shumicën e vendeve ish-komuniste të Evropës, si **Polonia** dhe **Hungaria**, si dhe **Kosova.** Modeli i tretë është ai model në të cilin caktimi i gjyqtarëve bëhet përmes bashkëpunimit në mes të dy organeve, zakonisht ligjvënësit dhe shefit të shtetit. Ky model njihet me emrin **modeli i bashkëpunimit.** Si i tillë ekziston në **Shqipëri, Rusi, Sloveni, Sllovaki, Çeki** etj. Në këto vende nominimi bëhet nga shefi i shtetit e konfirmohet nga ligjvënësi, apo anasjelltas. Këtu në këtë model kërkohet një shkallë e lartë e kulturës së bashkëpunimit.[230] Sa për ilustrim, në vijim jepen disa detaje prej sistemeve të caktimit të gjyqtarëve kushtetues. **GJKAust** (**Verfassungsgerichtshof - VfGH**) ka gjithsejtë njëzetë gjyqtarë kushtetues: kryetarin, nënkryetarin, dymbëdhjetë gjyqtarë dhe gjashtë zëvendës të gjyqtarëve. Zgjidhen me mandat përjetshëm (deri në moshën 70 vjeçare). Me propozimin e qeverisë, shefi shtetit emëron kryetarin, nënkryetarin dhe gjysmën e gjyqtarëve (gjashtë) dhe zëvendës gjyqtarëve (tre). Gjysma tjetër gjithashtu emërohet nga shefi shtetit, por nga listat që i dërgojnë dhoma e ulët (Këshilli nacional) dhe dhoma e lartë (Këshilli federal) e parlamentit. Në **GJK-Gje** (**Bundesverfassungsgericht, BverfG**) janë gjashtëmbëdhjetë gjyqtarë, të cilët zgjidhen me mandat dymbëdhjetë vjeçar (punojnë deri të mbushin moshën gjashtëdhjetetetë vjeçare). Gjyqtarët kushtetues janë të sistemuar në dy trupa organizativ dhe zgjidhen posaçërisht për **senatin e kontesteve kushtetuese** dhe për **senatin e të drejtave themelore**. Secili senat ka nga tetë gjyqtarë kushtetues. Gjysmën e gjyqtarëve i zgjedh **Bundestag**-u (dhoma e ulët e parlamentit gjerman), kurse gjysmën tjetër Bundesrat-i (dhoma e lartë e parlamentit gjerman). Në diskursin e përditshëm, senatet shpesh emërtohet si "profesorati", sepse gjyqtarët kryesisht kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë profesorë të drejtësisë. Kjo nuk është kështu me **Austrinë**, ku dy dekadave të fundit dominojnë juristët nga praktika, gjyqtarë dhe avokatë, diçka që nuk mund të jetë në Gjermani, ku ekziston kufizimi në kuptim të asaj që së paku tre nga gjyqtarët kushtetues të secilit senat duhet të jenë nga gjykatat federale, kurse pjesa tjetër plotësohet, siç u tha, kryesisht nga radhët e profesorëve të drejtësisë. Meqë gjyqtarët kushtetues i zgjedhin organet politike, ata në fakt janë kandidatë të partive politike, por jo edhe anëtarë të tyre, dhe bëjnë marrëveshje me rastin e kandidimit dhe zgjedhjes në funksionin e gjyqtarit kushtetues.

Gjykata Kushtetuese e Italisë (GJKIt), **Corte costituzionale della Repubblica Italiana**, përbëhet nga pesëmbëdhjetë gjyqtarë, të cilët i zgjedhin tri organe për një mandat prej nëntë vjetësh. Gjyqtarët nuk mund të rizgjidhen më. Pesë gjyqtarë i zgjedh Presidenti Republikës, pesë i zgjedhë Parlamenti dydhomësh me një shumicë të kualifikuar në mbledhjen e përbashkët të dy dhomave (Dhoma e Përfaqësuesve dhe Senati), kurse pesëshen e fundit e zgjedh pushteti gjyqësor – gjykatat e rregullta dhe gjykatat administrative (Gjykata supreme e kasacionit – tre, kurse këshilli shtetëror si gjykatë administrative dhe Gjykata e auditimit nga një gjyqtarë). Gjyqtarët nga radha e tyre e zgjedhin kryetarin e **GJKIt**. Edhe këtu gjyqtarët janë juristë të karrierës (universitare, gjyqësore, avokatisë), të cilën e lënë pas marrjes së detyrës. Nuk mund të jenë as anëtarë të partive politike.

[230] Cf. më shumë për tri modelet në trajtimet doktrinare të autorëve si vijon: Zdenk Kühn and Jan Kysela, "Nomination of Constitutional Justices in Post-Communist Countries: Trial, Error, Conflict in the Czech Republic". *European Constitutional Law Review* Volume 2 Issue 02 (June 2006) fq. 183 – 208 në fq. 185-188; Katalin Kelemen, "Appointment of Constitutional Judges in a Comparative Perspective – with a Proposal for a New Model for Hungary". *Acta Juridica Hungarica* Vol. 54 No. 1 (2013) fq. 5-23 në fq. 11-19; Për një klasifikim pak më ndryshe të modeleve, cf. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *The Composition of Constitutional Courts*, paragrafi 1.1 ["Systems of Appointment"]: European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Judicial Appointments*. Venice, 22 June 2007. **Opinion No. 403/2006. CDL-AD(2007)028.** Or. Engl. Paragrafët: 8-17. Në internet: http://www.venice.coe.int/webforms/documents/CDL-AD(2007)028.Aspx (shikuar në janar 2023).

GJSAm ka nëntë gjyqtarë, të cilët i emëron presidenti i SHBA-së, në bazë të mendimit dhe me miratimin e Senatit (dhoma e lartë e Kongresit). Gjyqtarët kanë mandat të përjetshëm, mbajnë funksionin e tyre deri kur të duan vetë dhe nuk kanë kufizime në moshë të pensionit. Presidenti i SHBA-së emëron edhe kryetarin e **GJSAm** (**Chief Justice**). **KAm** nuk specifikon kualifikimet për gjyqtarë të GJSAm, siç janë mosha, arsimimi, profesioni, apo shtetësia e fituar me lindje. Gjyqtari në GJSam nuk duhet të jetë jurist, avokat apo gjyqtar, por në të shumtën e kohës, të gjithë gjyqtarët kanë qenë të trajnuar në drejtësi. Ata nuk janë personalitete politike.

Nëntë anëtarët e **KKFr** zgjidhen për një mandat prej nëntë vjetëve. Bëhet fjalë për një organ që nuk është gjykatë dhe as nuk hyn në degën e gjyqësorit francez. Për pasojë, anëtarët nuk duhet të jenë juristë dhe as që kërkohet të kenë përvojën e juristit. Nga një e treta emërohen dhe zgjedhen nga organet për sa vijon: nga Presidenti i Republikës, që emëron edhe presidentin e **KKFr**, dhe kryetarët e dhomave të ulëta dhe të larta të parlamentit francez (Kuvendit Nacional dhe Senatit). Në përbërjen e tij, në bazë të funksionit të mëhershëm, hyjnë edhe ish-kryetarët e Republikës. Nuk ekziston ndalesa e të qenit anëtar i partisë politike, por ekziston një gamë e gjerë e funksioneve që janë të papajtueshme me të qenit anëtar të **KKFr**.

26.3. Kompetenca e organit të gjyqësisë kushtetuese

Si kompetencë e parë e organit të gjyqësisë kushtetuese, natyrshëm paraqitet mbrojtja e kushtetutës në procedurën e vlerësimit (kontrollit) të kushtetutshmërisë së akteve juridike. Kjo kompetencë mund të jetë e formuluar asisoj që bëhet vetëm vlerësimi i kushtetutshmërisë së krejt akteve të përgjithshme juridike (**Gjermania**, ku ligjshmërinë e vlerësojnë gjykatat e rregullta), apo vetëm i ligjeve dhe akteve me fuqi ligjore (**Italia**). Në kuptimin më të gjerë të fjalës, kontrolli i kushtetutshmërisë ka të bëj me kushtetutshmërinë e ligjit, marrëveshjeve ndërkombëtare (zakonisht kontrolli i tyre preventiv, para se të hyjnë në fuqi për palët), kushtetutshmëria dhe ligjshmëria e dekreteve dhe akteve të tjera të qeverisë, rregulloreve të parlamentit, akteve juridike të njësive federale, regjioneve, njësive të vetëqeverisjes lokale. Vlerësimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë bazohet në rregullin sipas të cilit të gjitha aktet, por edhe të gjitha veprimet dhe mosveprimet e autoriteteve publike, duhet të jenë në pajtim me kushtetutën, kurse aktet me fuqi më të ulët se ligji duhet ët jenë në pajtim me ligjin. Vetë procedurën e vlerësimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë e nisin subjektet e autorizuara, qoftë si kontest abstrakt ose konkret.

Organi i gjyqësisë kushtetuese vendos për **konfliktin për kompetencë** në rastet kur vjen deri të mosmarrëveshja rreth asaj se cili organ ka të drejtë të veprimit për një çështje, lëndë të caktuar. Nëse dy ose më shumë organe konsiderohen kompetentë, atëherë ekziston **konflikti pozitiv për kompetencë**, kurse nëse refuzojnë të veprojnë, mohojnë kompetencën dhe nuk duan të veprojnë për një çështje, lëndë konkrete, atëherë bëhet fjalë **konfliktin negativ për kompetencë**. Gjykata kushtetuese zgjidhë konfliktin për kompetencë që lind mes organeve shtetërore, organeve qendrore dhe organeve joqendrore, si dhe mes organeve joqendrore. Kjo kompetencë është shumë e rëndësishme në **shtetet e përbëra**. Ajo konsiston në zgjidhjen e konflikteve për kompetencë mes shtetit dhe njësisë federale si dhe mes vetë njësive federale në një shtet federal, ose me zgjidhjen e konflikteve të njëjta mes shtetit dhe regjioneve në një shtet regjional (Italia, Spanja). E lidhur me këtë është edhe e drejta e gjykatës kushtetuese për të mbrojtur të drejtën për autonomi regjionale dhe vetëqeverisje lokale, në rastet kur kjo e drejtë shkelet (cenohet) nga pushteti qendror. Në të njëjtën kohë, gjykata kushtetuese mbron edhe kompetencën e shtetit kur ajo uzurpohet (përvetësohet) nga aktet e njësive joqendrore politike – regjioneve, krahinave, qyteteve, komunave, më së shpeshti nga njësitë federale.

Organi i gjyqësisë kushtetuese vendosë për **kontestet zgjedhore** dhe shkeljen e të **drejtës së zgjedhjeve** (**Austria**, **Gjermania**, **Franca**). Mund të funksionoj si gjykatës zgjedhore në shkallë të fundit, të kontrolloj krejt procesin zgjedhor apo të vendos për shkeljen (cenimin) e legjislacionit zgjedhor vetëm në disa zgjedhje (parlamentare dhe për president të republikës). Këtu hyn edhe kompetenca për të vendosur mbi ligjshmërinë e **referendumit** (**Franca**).

Organi i gjyqësisë kushtetuese ka të drejtë të **ndaloj punën e organizatës politike**. Kjo kompetencë ka rrënjët e saj nga Gjermania, është zgjeruar në shtetet tjera si dhe ndaj organizatave dhe shoqatave të tjera, jo vetëm ndaj partive politike, siç janë: kishat, sindikatat, lëvizjet e regjistruara dhe të paregjistruara dhe grupimet. Arsyet për ndalim përcaktohen me kushtetutë, kurse në procedurën provuese vlerësohet nëse janë përmbushur kushtet e tilla kushtetuese.

Të ndryshme janë autorizimet e gjykatave kushtetuese në procedurën e **shkarkimit të shefit të shtetit**: marrin vendim mbi përgjegjësinë për shkeljen e kushtetutës ose tradhtinë e madhe (Italia), vendosin nëse ka qenë e ligjshme nisja e procedurës së shkarkimit të shefit të shtetit (Rusia), udhëheq me procedurën dhe shkarkon shefin e shtetit (Gjermania, Hungaria). Gjykata kushtetuese mund të ketë autorizim për të gjykuar dhe shkarkuar bartësit tjerët të pushtetit, siç janë: gjyqtarët e gjykatës supreme, gjyqtarëve, anëtarëve të parlamentit, ministrave (Gjermania, Italia).

Gjykata kushtetuese është organ i mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut. I mbron tërthorazi kur anulon ose shfuqizon aktet e përgjithshme jokushtetuese dhe joligjore. I mbron drejtpërdrejtë liritë dhe të drejtat e njeriut kur vendos në procedurën e nisur sipas ankesës kushtetuese (Gjermania, Spanja). Ankesën kushtetuese mund ta paraqes çdo kush që konsideron se me akt individual ose veprim të organit shtetëror, organit tjetër të pushtetit si dhe subjektit me autorizime publike iu janë shkelur liritë dhe të drejtat njerëzore. Kjo kompetencë është menduar si një përjashtim, si një lloj rruge e posaçme për rastet e shkeljeve më të rënda të lirive dhe të drejtave njerëzore, por me kalimin e kohës është bërë puna kryesore dhe identifikuese e gjyqësisë kushtetuese bashkëkohore. Sot gjykatat kushtetuese në pjesën më të madhe të vendeve evropiane dhe përtej, ngarkesat në punë mbi 80 % i kanë me lëndët apo rastet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut. Në të njëjtën kohë, gjykata kushtetuese ka të drejtë edhe në drejtim të kundërt – të veproj në mënyrë represive ndaj qytetarët dhe të kufizoj liritë dhe të drejtat e tyre në rastet e caktuara, ta zëmë të drejtat politike (Gjermania).

Gjykata kushtetues merr pjesë në zgjidhjen e çështjeve kruciale politike, siç janë: bartja e kompetencave të shtetit në organizatat ndërkombëtare, ta zëmë në BE, vlerësimin e kushtetutshmërisë së referendumit në njësinë politike brenda shtetit, vlerësimin e kushtetutshmërisë së marrëveshjes për territor dhe kufij, lëshohet edhe në vlerësimin e kushtetutshmërisë së akteve politike të qeverisë që në teori konsiderohen si të përjashtuara nga kontrolli gjyqësor i kushtetutshmërisë së tyre (Gjermania).

Në realizimin e krejt këtyre kompetencave, organi i gjyqësisë kushtetuese interpreton kushtetutën, duke i dhënë kuptimin e drejtë dhe përkatës në çdo rast konkret. Gjykata kushtetuese ka të drejtë të interpretoj edhe ligjin, në rastin konkret kur duhet të zbatohet, që do të thotë se kjo paraqet sinjal për parlamentin dhe qeverinë që ligjin duhet ndryshuar e plotësuar, konform kuptimit që ia ka dhënë (Italia). Gjykata kushtetuese interpreton kushtetutën edhe në lidhje me ndonjë çështje tjetër që ka lindur ose që do të lind, kur në kushtetutë për të nuk ka dispozita precize ose ajo çështje nuk rregullohet drejtpërdrejtë, ta zëmë, çështja e fuqisë juridike të preambulës, procedura e këmbimit të pjesëve të territorit etj.

27. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

27.1. Historiku

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, në vazhdën e themelimit të organeve të reja të shtetit, u themelua edhe **Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës** (GJKRKS). Në aspektin formalo-juridik, ajo është themeluar me hyrjen në fuqi të **Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës** (Ligji nr. 03/L-121).[231] Në aspektin real, ndërkaq, formimi i saj ka ndodhur

[231] Ky ligj u miratua nga **Kuvendi i Republikës së Kosovës** më 16 dhjetor 2008. Është shpallur me Dekretin Nr. DL-070-2008, të 30 dhjetorit 2008. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*/Prishtinë: Viti IV/nr. 46/15 janar 2009. Hyrja në fuqi është rregulluar me nenin 58 [“Hyrja në Fuqi“] të Ligjit, i cili përcakton si kohë të hyrjes në fuqi momentin e publikimit të tij në

vetëm më datën 26 qershor të vitit 2009, kur gjyqtarët e këtij organi dhanë betimin para Presidentit të Republikës, **Fatmir Sejdiu**, personi që do të gjendet në shkelje të **Kushtetutës së Republikës së Kosovës** (**KKos**) vetëm një vit më vonë.[232] Në mënyrë efektive, ndërkaq, ajo ka nisur punën e saj në shtator të po atij viti.[233] Para kësaj periudhë, organi i gjyqësisë kushtetuese kosovare ka ekzistuar në kuadër të zhvillimeve politike dhe kushtetuese të ish-**Jugosllavisë** [234] dhe, më pas, brenda zhvillimeve lidhur me **Kushtetutën e Kaçanikut** (1990) dhe **Kushtetutën e Rambujesë** (1999). Në periudhën e administrimit ndërkombëtar të Kosovës, as që ka mund të bëhet fjalë për gjyqësi kushtetuese, për faktin e thjeshtë se UNMIK-u, si një agjenci i OKB-së në Kosovë, nuk ka mund të jetë objekt kontrolli kushtetues. Sikundër dihet, kontrollin e punës së organeve të OKB-së nuk e ushtron askush, as **GJND-ja**, si institucioni më i lartë gjyqësor brenda **OKB**-së që bën interpretimin e të drejtës ndërkombëtare dhe burimeve të saj në procesin e zgjedhjes së mosmarrëveshjeve juridike dhe dhënies së mendimeve këshilldhënëse, procese që iniciohen nga shtetet dhe subjekteve tjera të autorizuara me **Kartën e OKB-së** dhe **Statutin e GJND-së**.

Kushtetuta ish-**Jugosllavisë** e vitit 1963 për herë të parë parashikon themelimin e **Gjykatës Kushtetuese të RSFJ-së** dhe gjykatave kushtetuese republikane. Kjo ndodhë për herë të parë në një vend komunist dhe paraqet arritje të madhe për kohën. Në literaturë janë dhënë dy arsye kryesore që kanë shkaktuar themelimin e kësaj gjykate, e cila në tërësi është modeluar sipas konceptit **evropian/kelzenian**. Ato arsye janë për sa vijon:

- e para, futja e vetëqeverisjes si një sistem i ri qeverisës që dukshëm dallonte nga të gjitha vendet tjera ish-komuniste në të cilat shteti dhe aparati shtetëror dominonin të gjitha sferat e jetës,[235] dhe,
- e dyta, fuqizimi i rolit dhe pozitës së individit në një sistem socialist që bazohej në këtë model qeverisës, që thuhej se ishte më e favorshme krahasuar me vendet tjera të universit komunist sepse kishte një ”fytyrë humane”.[236]

Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

232 Cf. *Rasti KI 47/10. Aktgjykim. Naim Rrustemi dhe 31 deputet të Kuvendit të Kosovës kundër Shkëlqesisë së tij, Fatmir Sejdiu, President i Republikës së Kosovës.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. Ref.: AGJ 43/10. Prishtinë: 28 shtator 2010, paragrafi II i pjesës operative. Në këtë pjesë konstatohet shkelje serioze e **KKos**, respektivisht nenit të saj 88.2, nga Shkëlqesia e Tij, **Fatmir Sejdiu**, për shkak të mbajtjes njëkohësisht të postit të Presidentit te Republikës së Kosovës dhe postit të kryetarit të partisë politike - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

233 Përbërja e parë e **GJKRKS** është zgjedhur më 26 qershor 2009 dhe ka pasur këtë formacion: Enver Hasani, kryetar, Altay Surroi, gjyqtar, Ivan Cukalloviq, gjyqtar, Kadri Kryeziu, gjyqtar, Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare, Iliriana Islami, gjyqtare, Robert Carolan, gjyqtar, Almiro Rodriguez, gjyqtar, Snezhana Botusharova, gjyqtare.Sipas **KKos**, përkatësisht dispozitave të saj mbi pavarësinë e mbikëqyrur që kanë vlejtur deri në shtator të vitit 2012, në përbërjen e saj kanë qenë tre gjyqtarë ndërkombëtarë. Këta kanë vazhduar edhe për gjashtë vjet tjera mandatin e tyre, sipas një këmbimi të letrave që është bërë në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian.
Vendimi i parë i **GJKRKS** ka qenë në rastin **KI 11/09: Tomë Krasniqi vs RTK dhe KEK**, datë 16 tetor 2009, dhe ka pasur të bëjë me vënien e masës së përkohshme që ndalonte zbatimin e Ligjit për RTK-në deri në vendosjen meritore të rastit. Seanca e parë dëgjimore për këtë rast është mbajtur më 6 tetor 2009 në gjykatoren e **Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës**. Kjo sepse në këtë kohë ende nuk ka qenë ndërtuar gjykatorja e **Gjykatës Kushtetuese**.

234 Sa i përket organit të gjyqësisë kushtetuese në Kosovë gjatë ish-Jugosllavisë, kanë kuptim vetëm zhvillimet kushtetuese pas amendamenteve të viteve 1969, 1971 dhe 1972 në **Kushtetutën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë** (RSFJ) të vitit 1963, si dhe miratimi i **Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës** (KSAK).Periudha e viteve 1945-1969 ka qenë një periudhë gjatë së cilës **Kosova** nuk ka gëzuar ndonjë status të theksuar juridiko-kushtetues sepse është trajtuar si pjesë ekskluzive dhe integrale e **Republikës së Serbisë**, e cila ka qenë njësi federale e **RSFJ**. Identiteti kushtetues i Kosovës në kuadër të **RSFJ** ka marrë formë të plotë vetëm pas vitit 1974, vit kur u miratua kushtetuta e parë e Kosovës, **Kushtetuta e KSAK.** Me këtë kushtetutë, **Kosova** fitoi një status të veçantë juridik-kushtetues, shumë të ngjashëm më atë të ish-republikave jugosllave. Që nga viti 1974, **Kosova** dhe **Vojvodina** (kjo e fundit ende është pjesë autonome në Serbinë e Veriut) filluan të gëzonin statusin e autonomisë politiko-territoriale.

235 Dimitrije Kulic, *Ustavno sudstvo u svetu*. Drugo Izdanje (Leskovac, 1972) fq. 157-161.

236 Në literaturë, kjo kushtetutë cilësohet si një tekst i një vendi komunist që për herë të parë në kuadër të sistemit komunist të kohës ka filluar një interpretim më liberal të doktrinës marksiste – leniniste rreth ekonomisë dhe proceseve shoqërore: vetëqeverisja dhe decentralizimi ishin dy komponente të komunizmit jugosllav të cilat i jepnin sistemi politik dhe kushtetues një ”fytyrë humane“ krahasuar me vendet tjera të bllokut komunist. Cf. Dimitar Bechev, *Rival Power. Russia's Influence in South East Europe* (Yale University Press: Yale, 2017), fq. 25-26; Për fuqizimin e rolit të individit si arsye e dytë për krijimin e gjyqësisë

Amendamentet në Kushtetutën e vitit 1963 përbëjnë hyrje në revidim të tërësishëm të kësaj të fundit. Këto amendamente janë miratuar përgjatë viteve 1967, 1968 dhe 1971. Me to është forcuar roli i republikave dhe i krahinave autonome, forcim që u kurorëzua në vitin 1974 me nxjerrjen e Kushtetutës së RSFJ-së (Kushtetuta e RSFJ-së e vitit 1974) dhe kushtetutave të reja të republikave ish-jugosllave dhe Kosovës e Vojvodinës (si dy krahina autonome). Këto të fundit thuajse janë barazuar në statusin e tyre juridik-kushtetues me republikat federale, kurse vetë Federata u bë një forum konsensusi në mes të republikave dhe krahinave. Tani e tutje republikat dhe krahinat bëhen akterë kryesorë të **RSFJ-së** ashtu që çdo veprim i Federatës për çështjet kryesore i nënshtrohej marrëveshjes konsensuale në mes të republikave dhe krahinave.[237] Në një situatë të tillë vjen edhe deri të formimi i gjyqësisë kushtetuese në Kosovë, pra në vazhdën e forcimit të rolit dhe pozitës së Kosovës në kuadër të federatës jugosllave. Marrëdhëniet e reja, të siguruara me **amendamentet kushtetuese federale** të vitit 1968, të cilat siguronin pozitën e re të **Kosovës** në sistemin kushtetues të **RSFJ-së**, kanë ndikuar në zgjerimin e autonomitetit të **Kosovës** si krahinë autonome, përfshirë këtu të drejtën e saj që, nëpërmjet organit të vet, të mbrojë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë.[238] Prej këtij viti mund të flitet për kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë kosovare, sepse **KSAK-ja** fitoi të drejtën për të nxjerrë ligjin kushtetues (në vend të statutit të deriatëhershëm, i cili kishte qenë akti më i lartë juridik në Kosovë) dhe ligje (në vend të vendimeve, të cilat kishin qenë aktet më të larta në vend pas statutit). Në këtë mënyrë, funksionin e mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë nëpërmjet mekanizmit të gjyqësisë kushtetuese **Kosova** fillon ta ushtrojë pas nxjerrjes së **Ligjit Kushtetues të KSAK-së** në vitin 1969 (Ligji i vitit 1969), nëpërmjet **Degës së Posaçme Kushtetuese** pranë **Gjykatës së Lartë të KSAK-së (Dega e Posaçme).**[239]

Juridiksioni, palët e autorizuara dhe natyra e vendimeve të kësaj dege rregulloheshin me nenet 147 – 152 ["Gjykata e Lartë e Kosovës"] të **Ligjit të vitit 1969**. Sipas nenit 147, Dega e Posaçme vendoste:

- vendoste mbi përputhshmërinë e ligjeve krahinore me Ligjin e vitit 1969;
- vendoste mbi përputhshmërinë e dispozitave të tjera krahinore, dispozitave komunale dhe akteve të përgjithshme të organizatave punonjëse dhe organizatave të tjera vetëqeverisëse me Ligjin e vitit 1969 dhe ligjin krahinor; dhe
- kryente edhe punë të tjera që ishin lënë në kompetencën e saj me ligj krahinor.

Sipas paragrafit të fundit të këtij neni, **Dega e Posaçme** kishte për detyrë që të përcillte dukuritë me interes për realizimin e kushtetutshmërinë e ligjshmërinë dhe për këto dukuri njoftonte **Kuvendin e KSAK-së**, duke i dhënë atij mendime e propozime për nxjerrjen e ligjeve krahinore dhe për marrjen e masave përkatëse. Sikundër është diskutuar në kontekstin ish-jugosllav, një kompetencë të tillë e kanë pasur të gjitha gjykatat kushtetuese republikane dhe Gjykata Kushtetuese e RSFJ-së. Edhe pas rrënimit të komunizmit dhe pavarësimit të tyre, disa nga ish-republikat jugosllave e kanë ruajtur këtë lloj të detyrimit kushtetues kundrejt dukurive të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. **Kosova** nuk e ka bërë një gjë të tillë.

kushtetuese jugosllave krahas arsyes që lidhet me rendin objektiv kushtetues të sanksionuar me kushtetutë, cf. po ashtu edhe te Dimitrije Kulic, *Ustavno sudstvo u stevu*, fq. 160.

237 Cf. Mari-Žanin Čalić, *Istorija Jugoslavije u XX veku*, (CLIO: Beograd, 2004), fq. 284-285 & 293-313. Libri është në gjuhën serbe, alfabeti cirilik.

238 Për trajtimin më shterues dhe të thellë të autonomisë së Kosovës në ish-Jugsollavi, cf. monografinë e profesorit të ndjerë Kurtesh Salihu, *Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e autonimitetit të krahinës socialiste autonome të Kosovës në Jugosllavinë socialiste* (Entiti Teksteve dhe Mjeteve Mësimore: Prishtinë, 1984).

239 Ligji i parë kushtetues i KSAK-së është nxjerr në vititn 1969. Cf. **Ligja Kushtetuese e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës**, botuar në *THGB Fletorja Zyrtare e KSAK*. Prishtinë (1969). Në këtë botim është dhënë edhe fjala e **Fadil Hoxhës**, funksionarit kryesor komunist të **Kosovës**. Në këtë fjalë hyrëse, shprehet entuziazmi e madh i tij dhe gjeneratës së kohës për nxjerrjen e këtij ligji dhe shfuqizimin e **Statutit të Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë**. Kjo sepse, Statuti ishte një akt juridik i dobët që derivonte nga vullneti i **Republikës së Serbisë** dhe ishte pjesë përbërëse e vetëqeverisjes lokale të llojit komunist të kohës, kurse Ligji Kushtetutës sanksiononte një autonomi politiko-territoriale, po ashtu të tipit komunist, por me një përmbajtje dukshëm me të avancuar dhe që nuk bënte pjesë në vetëqeverisjen lokale. Cf. për këtë më shumë në Kurtesh Salihu, *Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e autonimitetit të krahinës socialiste autonome të Kosovës në Jugosllavinë socialiste*, fq. 140-150.

Si palë të autorizuara për t'u paraqitur pranë këtij organi kushtetues kanë qenë të gjitha organet e pushtetit qendror në **KSAK**, individët, organizatat punuese dhe organizatat tjera vetëqeverisëse dhe, në fund, vetë **Dega Kushtetuese** mund ta vinte në lëvizje procedurën **sua sponte**, me vetiniciativë. Sikundër shihet, ky juridiksion dhe palët e autorizuara janë të ngjashme me ato që kanë pasur gjykatat kushtetuese republikane, **Gjykata Kushtetuese e RSFJ** dhe, më vonë nga viti 1972, vetë **Gjykata Kushtetuese e KSAK-së**.[240] E njëjta vlen edhe për **natyrën juridike** të vendimeve të saj: nëse **Kuvendi i KSAK-së** brenda gjashtë muajsh nga dita e nxjerrjes së vendimit që konstatonte mospërputhje të ligjit krahinor me Ligjin e vitit 1969, nuk kryente harmonizimin e të parit me të dytin, atëherë ai ligj apo ajo dispozitë dilnin nga fuqia (shfuqizoheshin). Këtë dalje nga fuqia duhej ta konstatonte, sipas paragrafit të dytë të nenit 149 të Ligjit të vitit 1969, **Gjykata e Lartë e KSAK-së** me vendimin e vet përfundimtar. Në paragrafin e tretë në vijim të nenit të njëjtë flitej për vënien e masave të përkohshme ndaj zbatimit të ligjit si tërësi apo ndaj dispozitave të tij përkatëse, të cilat me vendim të **Degës së Posaçme** janë shpallur si të papajtueshme me Ligjin e vitit 1969. Sikundër shihet, në këto raste nuk bëhej fjalë për anulim (abrogim) të ligjit apo dispozitave të tij konkrete, të cilat me vendim janë shpallur si të papajtueshme me Ligjin e vitit 1969: një gjë e tillë parashikohej vetëm për aktet e tjera të përgjithshme më të ulëta se ligji. Kjo qartë përcaktohej në paragrafin e katërt dhe të fundit të nenit 149 të Ligjit të vitit 1969.
Efekti i vendimeve qe normuar me nenin 150 të **Ligjit të vitit 1969**, i cili në një paragraf të vetëm fliste për një gjë të tillë. Aty përcaktohej se çdo vendim që interpreton një normë të tij apo të ndonjë ligji tjetër, si dhe normat e ndonjë akti të përgjithshëm, atëherë ai vendim ka fuqinë e njëjtë me të, përkatësisht me ligjin e zakonshëm.

Në juridiksion të Degës të Posaçme nuk ka qenë kontrolli **incidental i kushtetutshmërisë**, për arsye krejt normale dhe të natyrshme: fakti që ajo, njëjtë si të gjitha gjykatat kushtetuese republikane dhe **Gjykata Kushtetuese e RSFJ-së**, me vonë edhe **Gjykata Kushtetuese e KSAK-së**, ka pasur të drejtën e vënies në lëvizje të vetvetes me vetiniciativë, **sua sponte**, juridiksioni incidental i këtyre gjykatave nuk do të kishte pasur asnjë kuptim.
Në bazë të Kushtetutës së **KSAK** të vitit 1974, **Gjykata Kushtetuese e KSAK-së** ka pasur juridiksion: [241]

- për të vendosur mbi pajtueshmërinë e ligjeve krahinore me **Kushtetutën e KSAK-së**;
- për të vendosur mbi pajtueshmërinë e statuteve të komunave me **Kushtetutën e KSAK-së** dhe ligjin krahinor;
- për të vendosur mbi pajtueshmërinë e dispozitave dhe të akteve të tjera të përgjithshme të organeve shtetërore, të organizatave të punës së bashkuar dhe të organizatave të bashkësive të tjera vetëqeverisëse me **Kushtetutën e KSAK-së**, me ligjin krahinor dhe me dispozitat tjera krahinore, me ligjin republikan me të cilin rregullohen me marrëveshje për territorin e **Republikës së Serbisë** (d.m.th. përfshirë këtu **KSA të Kosovës**, e cila atëherë, në aspektin kushtetues, ka qenë pjesë përbërëse e saj), si dhe mbi atë se a janë këto akte në kundërshtim me ligjin federative, për zbatimin e të cilit janë përgjegjëse organet në **KSA të Kosovës**;
- për të vendosur mbi pajtueshmërinë e dispozitave të organeve të **KSA të Kosovës** të nxjerra për zbatimin e ligjeve të **Republikës së Serbisë,** të cilat aplikoheshin në tërë territorin e Republikës;
- për të zgjidhur konfliktet mbi të drejtat dhe detyrat midis Krahinës dhe komunave në territorin e **Kosovës**, si dhe konfliktet midis dy a më shumë komunave në të njëjtin territor, në qoftë se për zgjidhjen e konflikteve të tilla nuk është parashikuar me ligj kompetenca e gjykatës tjetër;
- për të vendosur për zgjidhjen e konflikteve për kompetencë midis gjykatave dhe organeve tjera në **KSA të Kosovës**; dhe, së fundi,
- për të kryer edhe punë tjera që i janë lënë në kompetencë me Kushtetutë.

[240] Kurtesh Salihu, *Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e autonimitetit të krahinës socialiste autonome të Kosovës në Jugosllavinë socialiste*, fq. 141.
[241] Neni 372 ["Gjykata Kushtetuese e Kosovës"] i **Kushtetutës së KSAK-së**.

Në nenin 373 ["Gjykata Kushtetuese e Kosovës"] të Kushtetutës parashikohej detyra e saj për të përcjell dukuritë me interes për kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë krahinore dhe të informonte **Kuvendin e KSAK-së** për gjendjen e këtyre dukurive me interes. Në këtë kontekst, ajo ka pasur të drejtë që Kuvendit t'i propozojë nxjerrjen dhe ndryshimin e ligjeve të caktuara dhe marrjen e masave me qëllim të sigurimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë krahinore dhe mbrojtjes së të drejtave e lirive të vetëqeverisjes dhe ato qytetare të individëve dhe organizatave e bashkësive vetëqeverisëse. Autorizimet për përcjelljen e dukurive dhe informim të **Kuvendit të KSAK-së** për to kanë qenë të ngjashme për të gjitha gjykatat kushtetuese republikane dhe krahinore dhe për **Gjykatën Kushtetuese të RSFJ-së**, u mor vesh në domenin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë brenda territorit respektiv të secilës prej tyre. Kjo paraqet një relikt të ish-sistemit socialist, të cilin disa nga gjykatat kushtetuese të ish-republikave jugosllave e kanë ruajtur deri në ditët e sotme.

Në vijim të diskutimit si më sipër lidhur me cilësitë e përbashkëta të gjyqësisë kushtetuese kosovare në kohën **Jugosllavisë** socialiste, në kuptim të "konstitucionalizmit" të kohës, Kosova ka pasur cilësi që kanë qenë të njëjta me ato të shtetit të cilit i ka takuar. **Gjykata Kushtetuese e KSAK-së** (dhe ajo e **Vojvodinës**), njëjtë si gjykatat kushtetuese të njësive federale jugosllave dhe **Gjykata Kushtetuese e RSFJ-së**, i ka shërbyer ruajtjes së këtyre vlerave. Në fakt, vetë **Kushtetuta e RSFJ-së** e 1974 theksonte se liritë dhe të drejtat njerëzore garantohen me kushtetutë përveç nëse me ligj nuk përcaktohej ndryshe. Ky formulim, pra formulimi "përveç nëse me ligj nuk përcaktohet ndryshe", në mënyrë efektive i zhvlerësonte garancionet e dhëna kushtetuese lidhur me këto liri dhe të drejta individuale. Të gjitha gjykatat kushtetuese në **ish-Jugosllavi** ishin **evropiane/kelseniane** vetëm në formë: juridiksioni i tyre ka qenë e dizajnuar ashtu që ato të shërbenin vetëm si një instrument për ruajtjen e vlerave themelore të sistemit kushtetues socialist, i cili bazohej në supremacinë (epërsinë) e të drejtave kolektive të zhvillimit socialist, jo në mbrojtjen dhe promovimin e lirive dhe të drejtave individuale. Këto të fundit i nënshtroheshin diktatit të ligjshmërisë socialiste në tërësinë e tyre, për shkak se për ruajtjen e saj mund të bëhej kufizimi dhe cenimit i tyre në çdo kohë me anë të ligjit të zakonshëm.

Përgjatë viteve '80-të të shekullit të kaluar, **Kushtetuta e RSFJ-së** e vitit 1974 ka pësuar disa amendamentime. Reforma kushtetuese ndërmjet viteve 1981-1988, e realizuar përmes amendamenteve **I – VIII** dhe **IX-XLVIII** nuk ka qenë e natyrës së atillë sa të prekë apo ndryshojë identitetin kushtetuese të shtetit jugosllav. Ka qenë ardhja në pushtet në vitin 1986 e diktatorit serb **Slobodan Milosheviq** që ndryshoi çdo gjë në nivel jugosllav: nga kjo kohë, në **Serbi** u hap "kutia e Pandorës" së nacionalizmit serb, i cili provokoi fuqishëm edhe nacionalizmat tjerë, në rend të parë atë kroat dhe slloven, por edhe nacionalizmat që deri atëherë kishin qenë të fjetur (maqedonasit, myslimanët boshnjakë, hungarezët etj). Kjo u reflektua në zhvillimet kushtetuese përgjatë viteve 1989-1990, kur të gjitha kushtetutat e republikave dhe krahinave pësuan ndryshime rrënjësore, të cilat nuk përputheshin fare me **Kushtetutën e RSFJ-së** të vitit 1974, për shkak se përmbanin dispozita që ishin jashtë parimeve dhe normave të saj, si në formë ashtu dhe në përmbajtje. Kjo rrugë kundërkushtetuese e rrënimit të shtetit të fundit të sllavëve të jugut (me përjashtim të bullgarëve), në mënyrë simbolike nis me **Kosovën**, me amendamentet kushtetuese, të kryera me dhunë në rrethanat e gjendjes së jashtëzakonshme: **Kosova** dhunshëm u detyrua të pajtohet për ndryshimet kushtetuese me të cilat Serbisë i njihej e drejta për ta futur **Kosovën** nën dominimin e vet shtetëror në të gjitha fushat juridiko-politike, kushtetuese, socio – ekonomike, kulturore etj. Kjo ka ndodhur më 23 mars 1989. Me dhënien e këtij pëlqimi nga ana e **Kosovës**, **Serbia** miratoi amendamentet kushtetuese, në veçanti amendamentin **XLVII** në **Kushtetutën e Republikës së Serbisë** të vitit 1974. Me këtë hap **Kosova** humbi të drejtën e vetos në ndryshimin e **Kushtetutës së Serbisë**, të cilën e kishte gëzuar në bazë të **Kushtetutës së RSFJ** të viti 1974, veto që përbënte një garancion për krahinat autonome kundër dominimit dhe hegjemonisë serbe. Me këtë pëlqim të dhënë, **Kosovës** iu hapën rrugët për reintegrim të dhunshëm në tërësi në sistemin juridik – kushtetuese, socio-politik, ekonomik, kulturor dhe tjetër të **Republikës së Serbisë**. Kjo u pa një vit më vonë kur u miratua **Kushtetuta e Serbisë** (shtator 1990): me këtë kushtetutë statusi i **Kosovës** u reduktua në status të një autonomie lokale, duke përjashtuar, tani e tutje, çdo ndikim të shqiptarëve në vendimmarrje lidhur me punët e **Kosovës.**[242]

[242] Liljana Slavnić, *Ustavno pravo* (Privredna Akademija: Novi Sad, 2007) fq. 134- 135, 385-387.

Miratimi me dhunë i amendamenteve të datës 23 mars të vitit 1989, pati për pasojë reagimin e shqiptarëve në gjysmën e parë të vitit 1990: më 2 korrik u shpall **Deklarata e Pavarësisë së Kosovës,** kurse më 7 shtator 1990 u miratua **Kushtetuta e Kaçanikut**. Përgjigjja serbe qe shumë e ashpër: në qershor dhe korrik të vitit 1990, u nxorën dy ligje që i jepnin të drejtën **Republikës së Serbisë** për të vepruar në situatat e gjendjes së jashtëzakonshme në tërë territorin e saj, përfshirë **Kosovën**, me qëllim të sigurimit të ligjshmërisë, kushtetutshmërisë si dhe, siç thuhej atëbotë, respektimit të të drejtave dhe lirive njerëzore e të demokracisë. Përveç kësaj, këto ligje rrënuan tërësisht të gjitha institucionet kosovare të themeluara në bazë të kushtetutave të vitit 1974, të **RSFJ-së** dhe **KSAK-së**. Me këto dy ligje bëhej përligjësimi i gjendjes së jashtëzakonshme në Kosovë, e cila kishte nisur në pranverë të vitit 1989 me qëllim të detyrimit të **Kosovës** që të jepte pëlqimin në amendamentet e sipërcekura kushtetuese me të cilat **Kosova** u zhvesh në tërësi nga çdo e drejtë autonome që e kishte gëzuar sipas kushtetutave të **RSFJ-së** dhe **KSAK-së** të vitit 1974. Këto dy ligje, me fjalë të tjera, nuk bënin asgjë tjetër pos që në tërësi abrogonin autonominë e vjetër të gëzuar nga kosovarët si dhe rrënimin total të institucioneve të themeluara në mënyrë autonome nga Kosova. Kjo bëhej në kushtet e një gjendje të jashtëzakonshme, pra në gjendje të jashtëzakonshme po abrogoheshin nga ana e Serbisë të gjitha institucionet kosovare të themeluara sipas kushtetutave të **RSFJ-së** dhe **KSAK-së** të vitit 1974.[243] Me këtë, në mënyrë formale-juridike, Kosova po futej në sundim të drejtpërdrejt nga Beogradi në stilin e regjimeve koloniale të instaluara në mënyrë brutale nga ana e shteteve metropole. Këtu bënte pjesë edhe abrogimi i **Gjykatës Kushtetuese të KSAK-së**, e themeluar në vitin 1972 në bazë të amendamenteve kushtetuese të një viti më herët.[244]

Në **Serbi**, këta hapa u cilësuan si një sukses i madh sepse, siç thuhej, **Serbia** më në fund u bë shtet normal dhe anëtar i barabartë i **RSFJ**-së.[245] Më këtë qasje, u mor vesh, nuk pajtoheshin asnjëra prej ish-republikave jugosllave (përveç **Malit të Zi**, satelitit të **Serbisë** së asaj kohe, kurse **Vojvodina** nuk kishte arritur fare të rezistojë si pasojë e raportit të brendshëm të forcave në favor të serbëve lokal). Amendamentimi i kushtetutave republikane në kundërshtim të hapur me **Kushtetutën e RSFJ-së të viti 1974** vazhdoj edhe më fort nëpër republikat tjera, si reagim ndaj politikave agresive të Serbisë (dhe Malit të Zi).

Kur u nxor **Kushtetuta e Serbisë** në shtator të vitit 1990, **Kosova** fare nuk figuronte si entitet me të drejtë të vetos apo ndonjë të drejtë tjetër që kishte gëzuar në të kaluarën sipas dy kushtetutave të vitit 1974, të **RSFJ**-së dhe **KSAK-së**: me amendamentet në Kushtetutën e RS të Serbisë të datës 28 mars 1989, amendamentet IX-XLIX, u ndryshua procedura për ndryshimin e **Kushtetutës së RSS**: tani e tutje më nuk kërkohej pëlqimi i **Kosovës** dhe **Vojvodinës**. Kjo u bë e mundur pasi që, më datën 23 mars 1989, autonomia e Kosovës, e garantuar sipas **Kushtetutës së RSFJ-së** të 1974 ishte ndryshuar me dhunë nga ana e **Serbisë**.[246] Vitin në vijim, **Kosova** menjëherë shpall pavarësinë e vet nga Serbia më datën 2 korrik 1990, kurse më 7 shtator 1990 nxjerr **Kushtetutën e Kaçanikut**, në të cilën parashihet krijimi i organit të ri të gjyqësisë kushtetuese, sipas parametrave joidologjik. Për këtë flasim në më poshtë. Republika e Serbisë ende para nxjerrjes së **Kushtetutës së Kaçanikut**, reagoi ashpër ndaj këtyre hapave të kosovarëve duke shkatërruar çdo institucion të mbetur të Kosovë (kuvendin, organin ekzekutiv, gjykatat e rregullta dhe **Gjykatën Kushtetuese të KSAK-së**, si dhe çdo institucion tjetër). Këto masa çimentuan masat e gjendjes së jashtëzakonshme, të cilat, **de facto,** kanë zgjatur deri në çlirimin e Kosovës më 10 qershor 1999. Kjo nënkupton se **Kushtetuta e Republikës së Serbisë** e shtatorit të vitit 1990, edhe në aspektin formal, abrogon çdo element të autonomisë së Kosovës: tani e tutje,

243 Liljana Slavnić, *Ustavno pravo* (Privredna Akademija: Novi Sad, 2007), fq. 386.

244 Për **Gjykatën Kushtetuese të KSAK-së**, deri në rrënimin e saj nga diktatori serb **Slobodan Milosheviq**, cf. më shumë në Mirosal Cerar, "Slovenia's Constitutional Court Within the Separation of Powers". Në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer Law International: The Hague, 2010) fq. 213-245, në fq. 213, fusnota nr. 2; për zhvillimet kushtetuese në ish-Jugosllavi gjatë periudhës komuniste, Cf. më shumë në Jovan Gjorgjeviq, *E drejta kushtetuese* (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore të KSAK: Prishtinë, 1972), 5-114; Dimitrije Kulić, *Ustavno Sudstvo u Svetu*, fq. 157-190.

245 Liljana Slavnić, *Ustavno pravo*, fq. 385-386.

246 Kuvendi i **KSAK** në këtë ditë ka dhënë pëlqimin për ndryshimin e **Kushtetutës së RSS** me të cilin pëlqim autonomia e **Kosovës** dhe **Vojvodinës** në tërësi shuhet ashtu që më nga to nuk ka nevojë të kërkohet asnjë pëlqim për ndyrshime kushtetuese në **Serbi.** Cf. më shumë për këtë në librin e shkëlqyer të njërës prej protagonisteve të kohës, përfaqësues së popullit në Kuvendin e KSAK: Milihate Termkolli, *Marsi Acartë* (Kolegji AAB: Prishtinë, 2022).

Kosova nuk ka asnjë kompetencë kushtetuese dhe ligjvënëse, duke u kthyer kësisoj në gjendjen e viteve 1945-1969, kur dominohej e administrohej **de facto** dhe **de jure** nga regjimi në **Beograd**. Në këtë fazë, nga shtatori i vitit 1990, as që mund të bëhet fjalë për ndonjë gjyqësi kushtetuese kosovare.

Gjykata Kushtetuese e KSAK-së, e themeluar në vitin 1972, ka qenë dhe është e ndryshme nga **GJKRKS**. Funksioni i saj primar ishte ruajtja dhe kultivimi i vlerave të sistemit diktatorial komunist në Kosovë, si pjesë e sistemit komunist në ish-Jugosllavi, sistem që bazohej në unitetin e pushtetit të klasës punëtore. Ky pushtet, sipas kushtetutave të vitit 1974, jugosllave dhe kosovare, ushtrohej nga lidershipi komunist dhe në emër të klasës punëtore: partia komuniste, e njohur si **LKJ**, si parti e vetme në pushtet me rol prijës (avangardë) të garantuar me kushtetutë (jugosllave dhe kosovare). Përveç këtij dallimi themelore konceptual, ajo gjykatë ka pasur edhe dallime të tjera që kanë të bëjnë me juridiksionin dhe vetë mënyrën e saj të funksionimit. Sa i përket juridiksionit, siç u pa më herët, në juridiksion të vetin ajo ka pasur edhe mbrojtjen e ligjshmërisë, në ndërkohë që fare nuk e ka njohur institutin e **ankesës kushtetuese**. Si mekanizëm, ajo ka mund të vihet vetë në lëvizje edhe **sua sponte**. Jo vetëm kaq! Si një mekanizëm i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, ajo ka pasur edhe detyrën e mbikëqyrjes së fenomeneve që kanë të bëjnë me kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, përkatësisht të mbikëqyrë lëvizjet dhe zhvillimet në sferën e kushtetutshmërisë e të ligjshmërisë dhe t'i raportojë të njëjtat në kuvendin krahinor, në mënyrë të njëjtë siç kishin detyrë ta bënin të gjitha gjykatat kushtetuese në territorin ish-jugosllav për territoret e tyre juridiksionale.

Gjykata Kushtetuese e KSAK-së ka pasur dhe kompetenca të tjera që nuk janë aspak në natyrën e gjyqësisë kushtetuese që modelohet sipas sistemit të konstitucionalizmit perëndimor. Kjo, në fakt, në tërësi përputhet me natyrën dhe funksionin e kushtetutës dhe ligjit në një sistem komunist që bazohet në sistemin e kuvendeve dhe unitetit të pushtetit me partinë komuniste si avangardë e klasës punëtore dhe zbatuese e diktaturës së kësaj klase.[247] Dija dhe përvoja kushtetuese, e prodhuar nga kjo gjykatë kushtetuese në kohën e ish-**Jugosllavisë**, në asnjë mënyrë nuk ka mundur të shërbejë si pikë referimi për të gjykuar mbi vendimmarrjen e **GJKRKS-së**, si dhe për cilësinë e saj. Për fat të keq, megjithatë, ka ndodhur që shpeshherë analiza e "vendimeve të mëdha" të saj është bërë pikërisht nga kuadrot kosovare të kohës së komunizmit gjë që ka shkaktuar konfuzion në publik: analizat në fjalë janë bazuar në tërësi në parametrat e gjyqësisë kushtetuese të kohë së ish-Jugosllavisë. Kjo vlen, në veçanti, për analizat e tilla të bëra gjatë kohës sa ka qenë kryetar i saj autori i parë i këtij libri (2009-2015): analizat e vendimeve të **GJKRKS-së** që bëheshin nga "ekspertë kushtetues", në thelb ishin analiza që merrnin për bazë gjyqësinë kushtetuese të kohës së komunizmit. Një shprehje emblematike që vërteton këtë, është se këta "ekspertë kushtetues", pa qenë të bindur se po shpërfaqnin padije themelore, kontestonin juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës për të marrë aktgjykime: si është e mundur, thoshin këta ekspertë, që një gjykatë kushtetuese të marrë aktgjykime (sic!). Kjo logjikë flet mjaft, pa pasur nevojë të analizohen dijet e tyre në sferat tjera të juridiksionit që ka sot gjyqësia kushtetuese në Kosovë.

Gjykata Kushtetuese e KSAK-së ka ekzistuar në mënyrë efektive deri më 23 mars 1989. Në këtë datë, diktatori serb **S. Milosheviq** e rrënoi si të tillë, së bashku me autonominë që Kosova kishte gëzuar sipas Kushtetutës së vitit 1974.[248] Në aspektin formal, ajo ka vazhduar edhe pak muaj deri vitin në vijim kur formalisht, në fund të verës së vitit 1990, u suprimuan të gjitha organet e **KSAK-së,** proces që u kurorëzua me nxjerrjen e **Kushtetutës së Serbisë** (shtator 1990). Në këtë kohë, nga marsi 1989 deri në fund të verës së vitit 1990, **Serbia** në mënyrë graduale e vuri **Kosovën** në tërësi nën thundrën e sistemit të saj juridik-kushtetues, duke rrënuar të gjitha shenjat e identitetit kushtetues që vendi kishte gëzuar me vite sipas kushtetutave të vitit 1974 (të RSFJ-së dhe KSAK-së).[249] Kjo politikë prodhoi rezistencë masive në mesin e popullsisë shumicë në **Kosovë**, e cila

[247] Për natyrën e pushtetit dhe për rolin e të drejtës në sistemin komunist të vendeve të ish-bllokut socialist, Cf. më shumë në Paolo Carroza, "Il diritto socialista". Në Paolo Carrozza - Alfonso Di Giovine - Giuseppe F. Ferrari (eds.), *Diritto costituzionale comparato* (GLF Editori Laterza: Roma-Bari, 2009), fq. 583-615; Karl J. Fridrih, *Kosntitucionalna Demokratija* (CID: Podgorica, 2009), fq. 47-50.

[248] Miroslav Cerar, "Slovenia's Constitutional Court Within the Separation of Powers", fq. 213 fusnota nr. 2.

[249] Sipas **Kushtetutës së Serbisë** (shtator 1990), autonomia e Kosovës të cilën e gëzonte sipas Kushtetutës së RSFJ-së të vitit 1974, u suprimua dhe nuk ekzistonte më. Nenet 108-112 ["Krahina Autonome e Vojvodinës dhe Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë"] të Kushtetutës përcaktonin elementet bazë të "autonomisë së re" për Kosovën, kurse neni 6 ["Dispozitat Themelore

deri në fillim të vitit 1998 pat qenë krejtësisht paqësore nën udhëheqjen e liderit të **LDK**-së dhe presidentit të parë të **Kosovës**, **Dr. Ibrahim Rugova (1944-2006).** Gjatë kësaj kohe, kosovarët organizuan jetë paralele në sferën politike, sociale, arsimore, shëndetësore dhe ekonomike. Ky organizim paralel kishte për qëllim refuzimin e tërësishëm të integrimit të **Kosovës** në **Serbi**. **Kosova** dhe populli i saj shumicë **de facto** u përjashtuan nga çdo aspekt i jetës publike. Ata arritën, megjithatë, që t'i krijojnë vetes një lloj hapësire të jetës paralele publike, e cila jetë për serbët cilësohej si e huaj, por që me shumë sukses bashkekzistonte me hapësirën publike të imponuar me dhunë nga regjimi serb në **Kosovë**. Hapësira e imponuar serbe, për fat të keq, gjeti një përkrahje të madhe në mesin e popullsisë lokale serbe në **Kosovë**. Kjo situatë zgjati deri në fillim të vitit 1998, kur filloi një kryengritje e armatosur kundër regjimit të instaluar të Beogradit nën **udhëheqjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës** (UÇK). Produkti më emblematik i kohë së jetës publike paralele në **Kosovë**, të organizuar nga **LDK-ja** e **Ibrahim Rugovës** (Dr. Ibrahim Rugova: 1944-2006) dhe qeveria e tij në mërgim e udhëhequr nga Dr. **Bujar Bukoshi**. Fjalën e kemi për **Kushtetutën e Kaçanikut**, e cila është miratuar nga përbërja e legjislaturës së fundit të **Kuvendit të KSAK-së**. Në këtë përbërje kanë marrë pjesë vetëm shqiptarët dhe disa prej deputetëve të komuniteteve joserbe dhe joshqiptare të **Kosovës**. Kuvendi ka vepruar në ilegalitet si pasojë e represionit serb dhe është mbledhur në **Kaçanik** të Kosovës për të miratuar këtë kushtetutë. Kjo ka ndodhur më datën 7 shtator 1990, në paralel me hapat e ngjashëm që i ndërmerrnin republikat ish-jugosllave dhe popujt e tyre në vijim të rezistimit të hegjemonisë serbe.

Në kuadër të pjesës së VII ["Organet Republikane"] të **Kushtetutës së Kaçanikut**, kapitulli 6 bënte fjalë për **Gjykatën Kushtetuese**. Nenet 128-134 të këtij kapitulli kanë normuar juridiksionin dhe palët e autorizuara, zgjedhjen e gjyqtarëve e të kryetarit dhe imunitetin e tyre, disiplinimin e gjyqtarëve dhe kushtet për shkarkimin e tyre, mënyrën e vendimmarrjes dhe efektin juridik të vendimeve dhe, në fund, autonominë e rregullimit të saj të brendshëm. Juridiksioni ishte shumë i ngjashëm me juridiksionin e gjykatave kushtetuese të disa prej republikave ish-jugosllave të kohës, në veçanti me **Gjykatën Kushtetuese të Kroacisë**. Në nenin 128 të **Kushtetutës së Kaçanikut** thuhej se Gjykata Kushtetuese:

- vendos mbi pajtueshmërinë e ligjeve, dispozitave e akteve të tjera dhe statuteve të komunave e të qytetit me Kushtetutën;
- vendos mbi pajtueshmërinë e dispozitave dhe të akteve të tjera të organeve republikane me ligjin;
- vendos mbi pajtueshmërinë e të gjitha dispozitave dhe akteve të tjera me ligjin dhe dispozitën tjetër republikane;
- vendos mbi pajtueshmërinë e statutit ose të aktit tjetër të partive politike, të lëvizjeve, të lidhjeve dhe të shoqatave me Kushtetutën përkatësisht mbi kundërshtinë me ligj;
- vendos mbi ndalimin e punës së partive politike, të lëvizjeve, të lidhjeve dhe të shoqatave;
- vendos mbi përgjegjësinë e kryetarit dhe të anëtarëve të Kryesisë së Republikës për shkelje të Kushtetutës;
- zgjedh çështjet kontestuese të zgjedhjeve në qoftë se nuk janë në kompetencë të gjyqeve dhe të organeve tjera shtetërore;
- kryen edhe punë të tjera që i janë lënë në kompetencë me Kushtetutë.

Çështja e palëve të autorizuara për të vënë në lëvizje këtë gjykatë rregullohej me nenin 131, që përcaktonte se tri palë të autorizuara mund të paraqiteshin pranë gjykatës: secili individ, organet shtetërore dhe, në fund, vetë Gjykata **sua sponte.** Sikundër mund të vërehet nga kjo si më sipër, gjyqësia kushtetuese kosovare sipas

"] emërtonte **Kosovën** si një krahinë autonome, krahas **Vojvodinës**, që gëzon një lloj autonomie lokale, pa asnjë premisë të autonomisë së dikurshme politiko - territoriale.**Kushtetuta e Zhabljakut** (sipas emrit të vendit në Mal të Zi, ku është draftuar) ka sanksionunar këtë pozitë të **Kosovës** dhe **Vojvodinës,** duke respektuar në tërësi dispozitat e **Kushtetutës së Serbisë** të vitit 1990. Në kapitullin II, kjo Kushtetutë ka pasur dispozitat mbi të drejtat e njeriut, kapitull që titullohej: "Liritë, të Drejtat dhe Detyrat e Individit dhe Qytetarit" (nenet 19 – 68). Edhe pse në paragrafin 4 të nenit 124, Kushtetuta fliste për ankesën individuale në rastet e cenimeve me aktet individuale të autoriteteve publike të të drejtave dhe lirive të individit të garantuara me Kushtetutë, ushtrimi praktik i ankesës individuale në territorin e Kosovës nuk kishte asnjë gjasë dhe mundësi. **Kosova** dhe populli i saj ishin futur në një geto kolektive në duart e regjimit represiv të diktatorit serb **Slobodan Milosheviq** (Slobodan Milošević: 1941-2006).

Kushtetutës së Kaçanikut ka ruajtur disa prej premisave të gjyqësisë së mëhershme, njëjtë siç kishin bërë edhe republikat ish-jugosllave në atë kohë. Në rend të parë, Gjykata kishte në juridiksion të saj vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Në rend të dytë, në kuadër të juridiksionit të saj binte edhe kontrolli i kushtetutshmërisë së partive politike dhe shoqatave të qytetarëve sepse në këtë kohë ekzistonte frika se partitë politike dhe shoqatat e qytetarëve mund të futeshin në veprimtari të dhunshme anit-kushtetuese dhe antiligjore si pasojë e mungesës së përvojës në pluralizmin politik dhe respektimin e lirive dhe të drejtave njerëzore. Në fund, si palë të autorizuara paraqiten të gjithë individët dhe secili organ shtetëror. Nëse këta nuk ngrehnin çështjen e vlerësimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, atëherë vetë gjykata **sua sponte** mund të vihej në lëvizje. Kjo ka qenë një kompetencë e trashëguar nga përvoja e kaluara ish-jugosllave.

Në gjyqësinë kushtetuese sipas **Kushtetutës së Kaçanikut** nuk ka qenë e parashikuar **ankesa kushtetuese**, përkatësisht nuk parashikohej vënia në jetë të dispozitave të saj të kapitullit III ["Liritë, të Drejtat dhe Detyrat e Njeriut dhe të Qytetarit"]. Neni i fundit, neni 79 i këtij kapitulli, ka bërë fjalë për realizimin gjyqësor të të drejtave dhe lirive njerëzore, duke mos nënkuptuar me këtë gjyqësinë kushtetuese. Në nenin si më sipër 79 gjendej dispozita kushtetuese që sanksiononte një tjetër qasje lidhur me statusin e lirive dhe të drejtave njerëzore: aty thuhej se ato nuk mund të merreshin dhe as të kufizoheshin nga askush, ndërsa me ligj mund të përcaktoheshin vetëm mënyrat e realizimit të tyre. Hapur shihet se kjo dispozitë është futur me qëllim të largimit nga trashëgimia komuniste ku liritë dhe të drejtat kushtetuese mund të kufizoheshin dhe të merreshin në çdo kohë me një ligj të zakonshëm. Edhe sa i përket detyrave kushtetuese, **Kushtetuta e Kaçanikut** përbënte një risi sepse ato detyra duheshin përmbushur ekskluzivisht në bazë të dispozitave kushtetuese dhe jo të atyre ligjore apo në bazë të tekeve të politikës ditore, siç kishte ndodhur në kohën e sistemit komunist jugosllav. Edhe ky kapitull është i ndikuar nga dispozitat e ngjashme të kushtetutave demokratike të republikave ish-jugosllave, ku bëhej një lloj balancimi në mes të drejtave dhe detyrimeve dhe ku synohej realizimi sa më i gjerë i lirive dhe të drejtave kushtetuese, por duke mos parashikuar **ankesën kushtetuese** si mjet dhe si një mekanizëm për vënien në jetë të dispozitave të tilla. Kushtetutat e republikave ish-jugosllave shumë më vonë kanë parashikuar ankesën kushtetuese si mjet dhe një mekanizëm për vënien në jetë të dispozitave kushtetuese lidhur me liritë dhe të drejtat njerëzore. Për fund, shënojmë se **Kushtetuta e Kaçanikut** nuk ka pasur zbatim të kënaqshëm asnjëherë dhe efektivisht, për shkak të gjendjes së okupimit serb (1989-1999). Pas instalimit të administratës ndërkombëtare në Kosovë, më 10 qershor 1999, ka ardhur deri të ndërtimi i një rendi tjetër juridik, që nuk është bazuar në **Kushtetuta e Kaçanikut** por në aktet politike të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Para instalimit të kësaj administrate në Kosovë, ka pasur një konferencë ndërkombëtare, e njohur si **Konferenca e Rambujesë** (shkurt – mars 1999), e cila ka prodhuar një marrëvshje, e njohur si **Marrëveshja e Rambujesë**, e cila gjithashtu nuk është zbatuar asnjëherë: pas intervenimit të NATO-s kundër Serbisë dhe dëbimit të forcave serbe nga Kosova, me mbështetjen tokësore të **UÇK-së**, u krijua një administratë ndërkombëtare dhe një rend juridik ndërkombëtar bazuar në vullnetin politik të Këshillit të Sigurimit të OKB. **Kushtetuta e Rambujesë** ka qenë si shtojcë e parë e **Marrëveshjes së Rambujesë** dhe ka shërbyer si një pikë referimi për realizimin e lirive dhe të drejtave njerëzore dhe për mënyrën e ushtrimit të pushtetit. Në rast të konfliktit (mospajtimit) në mes tyre, marrëveshja kishte epërsi. Kjo është e kuptueshme nëse merret parasysh fakti se, njëjtë si në rastin e **Marrëveshjes së Dejtonit**, ky dokument përbënte shtojcë të saj, e cila ishte e vetmja që posedonte cilësinë e dokumentit me garancione ndërkombëtare. Neni i tretë dhe i katërt i **Kushtetutës së Kaçanikut** kanë bërë fjalë për kryetarin, qeverinë dhe administratën e **Kosovës**, kurse neni i pestë në pjesën e tij të përgjithshme e ka futur **Gjykatën Kushtetuese të Kosovës**, në kuadër të pushtetit gjyqësor kosovar. Në hierarkinë gjyqësore, megjithatë, nuk ka bërë pjesë Gjykata Kushtetuese. Kjo shihet në faktin se ekzistonin vetëm tri nivele të gjyqësorit kosovar: **Gjykata Supreme e Kosovës**, gjykatat e qarkut dhe gjykatat komunale. Përbërja dhe juridiksioni i **Gjykatës**

Kushtetuese përcaktohej me pikat 5-8 të nenit të pestë. Ajo duhej të kishte nëntë gjyqtarë, ku secili nga bashkësitë nacionale të Kosovës do ta kishte nga një, kurse pesë gjyqtarët tjerë qe përcaktuar se do të duhej të përzgjidheshin nga kryetari i **GJEDNJ-së**. Në pikën e gjashtë thuhej se autoriteti i saj shtrihej ndaj mosmarrëveshjeve që kanë të bëjnë me interpretimin e kuptimit të kushtetutës. Kjo do të thotë se fjala ka qenë për një gjykatë që do të duhej ta kishte autoritetin parësor në interpretimin e kushtetutës. Ky autoritet ka pasur të bëjë në rend të parë me konstatimin nëse ligjet e aplikueshme në Kosovë, vendimet apo aktet e kryetarit të Kosovës, të qeverisë, të komunave apo të bashkive nacionale ishin në përputhshmëri me kushtetutën. Ky autoritet nuk kufizohej vetëm në këto që u thanë më sipër. Kjo shihej nga pika e tetë e këtij neni që përcaktonte se juridiksioni i saj shtesë mund të përcaktohej me Marrëveshje dhe me ligj. Jo vetëm kaq: në pjesën e këtij neni që fliste për funksionimin e gjykatave, pikat 11-15, përcaktohej qartë se gjyqtarët në Kosovë mund të shkarkoheshin vetëm pas dhënies së pëlqimit paraprak nga **Gjykata Kushtetuese** (pika 13). Palët e autorizuara normoheshin me pikën gjashtë, nën germën ”a” dhe”b”, dhe pikën shtatë të nenit si më sipër. Ato palë mund ishin:

- kryetari i Kosovës, kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit të Kosovës;
- avokati i popullit;
- kuvendet dhe këshillat e komunave;
- secila bashkësi nacionale në pajtim me rregullat demokratike;
- çdo gjykatë e rregullt në rastet kur gjatë zgjidhjes së një çështje pranë saj has në një çështje e cila bie në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese (kontrolli incidental); dhe, së fundi,
- individët në ato raste kur konsiderojnë së janë viktimë e cenimit të të drejtave dhe lirive njerëzore si dhe të atyre të drejtave e lirive që u takojnë bashkësive nacionale, mirëpo pasi t’i kenë shterur të gjitha mjetet tjera juridike.

Në kuptim hierarkik, **Rezoluta 1244** e Këshillit të Sigurimit të OKB-së (10 qershor 19999), me të cilën u instalua administrata ndërkombëtare në Kosovë, paraqet ”kushtetutën” e **Kosovës** së pasluftës sepse ka qenë dokumenti me fuqi më të lartë juridiko-politike dhe themel i çdo akti juridik (të përgjithshëm apo individual) të nxjerrë nga **UNMIK**-u deri në shpalljen e pavarësisë më 17 shkurt 2008. Ndër aktet juridike të nxjerra në vijim të zbatimit të zotimeve të Rezolutës, dy kanë rëndësi të veçantë për diskutimin tonë në këtë libër: **Rregullorja Nr. 1991/1** dhe **Rregullorja Nr. 1999/24**. Aktet juridike në formë të rregulloreve kanë paraqitur aktivitetin primar ligjvënës të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (**PSSP)**.

Politikani finlandez**,Marti Ahtisari,** u caktua në nëntor të vitit 2005 si përfaqësues special i **OKB**-së për **Kosovën**, i mandatuar me mision të qartë për të analizuar situatën në terren, për të ndërmjetësuar në mes të palëve dhe, në fund, për të dhënë një propozim lidhur me statusin përfundimtar që Kosova do të duhej ta kishte në të ardhmen. Ky mandat bazohej në **Rezolutën 1244**. Pas shumë bisedimeve dhe negociatave të ndërmjetësuara nga ai dhe ekipi i tij i shkëlqyer,[250] në fillim të vitit

[250] Për detajet e bisedimeve, kohën e zgjatjes së tyre dhe gjendjen e brendshme të palëve dhe të vetë përfaqësuesit special **Marti Ahtisari** dhe ekipit të tij, cf. më shumë në: Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar. Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi* (KOHA: Prishtinë, 2009). Në kapitullin 12 autori diskuton detajet, si pjesmarrës në negociata të Vjenës dhe në negociatat tjera shtesë, vështirësitë dhe obstruksionin serb, kurse në kapitullin 13 autori analizon tekstin e **Planit Ahtisari** nga aspekti politiko - kushtetues dhe juridiko - ndërkombëtar; në klapituillin 14 autori paraqet detaje nga procesi i kushtetutëbërjes në **Kosovë**, gjithnjë në suazat e propozimeve të **Planit Ahtisari** dhe skicës juridiko – kushtetuese të draftuar nga ai, sikundër dhe për rolin e bashkësisë ndërkombëtare dhe ekspërtve vendor. Plani ka rëndësi të madhe sepse në mënyrë të drejpërdrejtë ka të bëjë me procesin e draftimit të Kushtetutës së Kosovës sipas rekomandimeve të kuadrit juridik të skicuar në te. Cf. edhe James Ker-Lindsay, *Kosovo: The Path to Contested Statehood in the Balkans* (I.B.Tauris & Co. Ltd.: London, 2009) (autori në kapitujt 2 dhe 3, nga një këndvështrim tërësisht pro-serb dhe por-rus flet për bisedimet e drejtpërdrejta në **Vjenë** dhe gjetiu me ndërmjetësimin e përfaqësuesit special **Marti Ahtisari** si dhe për propozimet konkrete dhe arsyet e serbëve për mospranim të **Planit Ahtisari).**

2007, presidenti i **KS-së** të **OKB**-së e qarkulloi një dokument që përmbante propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Ky dokument që nga kjo kohë u njoh me emrin **Plani Ahtisari**[251] dhe ishte i ndarë nga një letër, të cilën Marti Ahtisari, përmes Sekretarit të Përgjithshëm të **OKB**-së e dërgoi në **KS** të **OKB**-së për miratim. Në letër përmbaheshin rekomandimet konkrete për zgjidhjen përfundimtare të statusit të Kosovës: aty theksohej se pavarësia e mbikëqyrur e Kosovës ishte opsioni i vetëm për zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës, duke marrë parasysh historinë violente dhe vuajtjet e popullsisë shumicë nga regjimi i diktatorit **S. Milosheviq**, si kohën e gjatë të administrimit ndërkombëtar të **Kosovës** dhe vetë natyrën specifike të stipulimeve të **Rezolutës 1244**. **Plani Ahtisari** ka pasur epërsi ndaj **KKos**, e cila u miratua më 15 prill 2008. Këtë epërsi e ka garantuar vetë **KKos**, e cila ka ripërsëritur të njëjtat zotime për epërsinë e dispozitave të Planit që kanë figuruar në **Deklaratën e Pavarësisë** (17 shkurt 2008). Kjo për shkak se vetë Deklarata paraqet **grundnormën** e parë të Republikës së Kosovës, si shtet sovran dhe i pavarur, i njohur ndërkombëtarisht nga pjesa dërrmuese e vendeve të botës. Për më tepër, **KKos** flet edhe për epërsinë e dispozitave të Rezolutës 1244 të KS të OKB-së, rregulloreve dhe akteve të tjera të **UNMIK**-ut që kanë normuar fushat e ndryshme të jetës. Kjo epërsi ka vlejtur deri në nxjerrjen e ligjeve dhe akteve kosovare që kanë rregulluar materien e njëjtë.[252] Sa i përket epërsisë së përkohshme të rregulloreve dhe akteve të tjera të **UNMIK**-ut, ajo është futur në **KKos** përmes Deklaratës, në vijim të vënies në jetë të zotimit të njëanshëm të Kosovës për të respektuar **Rezolutën 1244**, e cila pas pavarësisë së Kosovës përfaqëson një rend tjetër juridik, i ndryshëm dhe i pavarur nga rendi juridik-kushtetues i ndërtuar pas 17 shkurtit 2008. Këtë konstatim e ka vënë në dukje edhe **GJND** në mendimin e saj për Kosovën. Në këto zotime hyjnë edhe zotimet tjera ndërkombëtare që ishin marrë nga **UNMIK**-u në emër dhe për llogari të Kosovës gjatë kohës së administrimit të tij në vend (10 qershor 1999 - 17 shkurt 2008).[253] Pas shpalljes së pavarësisë ka ekzistuar një fazë e ndërmjetme, ajo e **pavarësisë së mbikëqyrur** (2008-2012), në të cilën gjithashtu ka vlejtur epërsia e Planit Ahtisari dhe, përmes tij, edhe e akteve të tjera juridike të nxjerra nga autoritetet e UNMIK-ut. Këto shtjellime të shkurtra lidhur me epërsinë e akteve juridike me karakter ndërkombëtarë kanë rëndësi sepse tregojnë edhe vetë natyrën e gjyqësisë kushtetuese kosovare në këtë kohë. Kjo vërehet që nga përbërja e **GJKRKS**. Në kohën e parë, gjatë pavarësisë së mbikëqyrur dhe disa vite pas saj, ka ekzistuar një përbërje e përzier e **GJKRKS**, me gjykatës ndërkombëtarë dhe me gjykatës vendorë. Juridiksioni i saj u zgjerua shumë në krahasim me juridisionin e përcaktuar me **Planin Ahtisari**. Në fazën e parë, ky juridiksion ishte i ndërlidhur dhe kushtëzohej me llojin e pavarësisë që kishte Kosova, një pavarësi e mbikëqyrur ku epërsia e Planit, jo e dispozitave të **KKos**, përbënte esencën e kushtetutshmërisë së kësaj periudhe. Në fazën e dytë, pas mbylljes së kësaj pavarësie (shtator të vitit 2012), ka ardhur deri te shfuqizimi i dispozitave të planit mbi pavarësinë e mbikëqyrur. Kjo është bërë përmes amendamenteve kushtetuese, të nxjerra nga **Kuvendi i Kosovës**, me të cilat i jepej fund pavarësisë së mbikëqyrur dhe kufizimeve të juridiksionit material të **GJKRKS.** Tani e tutje, ky organ kishte për detyrë të sigurojë epërsinë e **KKos**, jo dispozitat e **Planit Ahtisari**. Kjo gjendje, megjithatë, nuk zgjati shumë. Ajo ndryshoi sërish në vitin 2013, në disfavor të epërsisë së **KKos**, ditën kur u themelua **Gjykata Speciale** (për të cilën folëm më sipër).

---

[251] **Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës**, 2 shkurt 2007. **Plani Ahtisari** përbëhej prej pjesës kuadër apo pjesës së përgjithshme dhe 12 (dymbëdhjetë anekseve) të kësaj pjese.

[252] Neni 145. 2 [Vazhdimësia e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe e Legjislacionit të Aplikueshëm] i Kushtetutës: "[…] 2. Legjislacioni i aplikueshëm në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute vazhdon të zbatohet për aq sa të jetë në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë, derisa të mos shfuqizohet, zëvendësohet ose amendamentohet në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë".

[253] Paragrafi 9 i Deklaratës së Pavarësisë: "[…] 9. Ne, nëpërmjet kësaj Deklarate, marrim obligimet ndërkombëtare të Kosovës, përfshirë ato të arritura në emrin tonë nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), si dhe obligimet e traktateve dhe obligimet tjera të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ndaj të cilave obligohemi si ish-pjesë konstituive, përfshirë konventat e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike dhe konsullore. Ne do të bashkëpunojmë plotësisht me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. Ne synojmë të kërkojmë anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, në të cilat Kosova do të synojë të kontribuojë për qëllime të paqes dhe stabilitetit ndërkombëtar".

27.2. Përbërja, mandati dhe statusi i gjyqtarëve kushtetues

Deri në qershor të vitit 2018, krahas **Bosnjë-Hercegovinës**[254] dhe **Lihtenshtajnit**,[255] **Kosova** ka qenë vendi i tretë në **Evropë** që ka pasur në përbërjen e vet tre gjyqtar ndërkombëtar. Prania e gjyqtarëve ndërkombëtarë ka pasur natyrë të përkohshme. Përndryshe, **kriteri i shtetësisë** përbën një ndër kriteret kyçe dhe një standard përgjithësisht i përqafuar, jo vetëm në modelin **kelsenian/evropian** të gjyqësisë kushtetuese, por edhe më gjerë. Përveç këtij kushti, kushtit të shtetësisë, kushtet e tjera të përcaktuara me kushtetutë dhe ligj kanë vlejtur për të gjithë gjyqtarët kushtetues, si për vendorët ashtu dhe për ndërkombëtarët, në të gjitha fazat e zhvillimit të **GJKRKS**. Kushti shtetësisë përcaktohet me **Ligjin nr. 03/L-121**,[256] jo me **KKos**.[257] Kjo qasje kosovare përbën një standard mjaft të përhapur: njëjtë si në vendet tjera, përmes ligjeve organike apo ligjeve të tjera të zakonshme, si dhe rregullave të brendshme që normojnë organizimin dhe punën e gjyqësisë kushtetuese, përcaktohen kritere shtesë lidhur me stafin, organizimin e jetës dhe punës në gjykatën kushtetuese. **Ligji nr. 03/L-121** dhe **Rregullorja e Punës (RrP)** duhet parë në këtë dritë, pra si dy instrumente juridike që shërbejnë për të operacionalizuar dispozitat kushtetuese dhe për të vënë kritere dhe kushte të tjera

---

254 Në rastin e **Bosnjë - Hercegovinës** tre nga gjyqtarët kushtetues nuk mund të jenë shtetas të këtij vendi dhe të asnjë vendi tjetër fqinjë me të. Këta tre gjyqtarë, të cilësuar si "gjyqtarë ndërkombëtarë", caktohen nga kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (**GJEDNJ)**. Ky stipulim kushtetues, i parashikuar në nenin VI të **Kushtetutës së Bosnje-Hercegovinës** është pjesë e detyrimit ndërkombëtar të marrë nga ky vend me **Marrëveshjen e Dejtonit** (nëntor 1995): **Kushtetuta e Bosnje-Hercegovinës** është pjesë integrale e **Marrëvështjes së Dejtonit** dhe gjendet në aneksin e saj të katërt. Cf. për tekstin e plotë të **Marrëveshjes së Dejtonit**, botuar në **The General Framework Agreement for Peace in Bosnia and Herzegovina**. **Initialled in Dayton on 21 November 1995 and signed in Paris on 14 December 1995.** Në internet https://www.osce.org/bih/ 126173?download=true (shikuar në 2022); Për komentet doktrinare të këtij stipulimi dhe rolin e gjyqtarëve ndërkombëtar në këtë vend, cf. Alex Schwartz and Melanie Janelle Murchison "Judicial Impartiality and Independence in Divided Societies: An Empirical Analysis of the Constitutional Court of Bosnia – Herzegovina". *Law & Society Review*, Vol. 50, No. 4 (2016) fq. 821-855 në fq. 824-830 (ku autori diskuton rolin e gjyqtarëve ndërkombëtarë, në veçanti në vendimet e rëndësishme që kanë ndarë trupin gjykues përgjatë vijave etnike dhe gati kanë paralizuar Gjykatën; autori u njeh në veçanti meritat këtyre tre gjyqtarëve ndërkombëtar për vendimet që kanë pasur të bëjnë me garantimin e barazisë së tri kolektiviteteve në nivel shtetëror, pra jo me barazinë e entitetve, sepse një praktikë e tillë në **Republika Srpska** në thelb përjashtonte barazinë e çdo joserbi; ky vendim ka bërë që tre popujt të kenë status të njëjtë dhe të barabartë në tërë territorin e **Shtetit të Bosnje-Hercegovinës**).

255 Në rastin e **Lihtenshtajnit**, praktika është që një gjyqtar vjen nga **Austria** dhe një tjetër nga **Zvicra.** Ky përcaktohet me nenin 105 të **Kushtetutës së Lihtenshtajnit** që përcakton se shumica e dhjetë gjyqtarëve (pesë nga ta janë gjqytarë rezervë) duhet të jenë shtetas të **Lihtenshtajnit.** Kjo është pjesë përbërese të historisë kushtetuese të kësaj principate.Vendi është monarki kushtetuese parlamentare e trashëgueshme. Cf. për tekstin e Kushtetutës në **Constitution of the Principality of Liechtenstein of 5 October 1921**. As of: 1 February 2014. Cf. **Conference of European Constitutional Courts**, XIIth Congress (2002). *The relations between the Constitutional Courts and the other national courts, including the interference in this area of the action of the European courts.* Report of the State Court of Justice of **Principality of Liechtenstein** by Prof. Dr. Andreas Kley. (ku autori flet për aktivitetin mjaft të pasur në planin ndërkombëtar të kësaj gjykate, e cila vepron si gjykatë e lartë e drejtësisë në çështje kushtetuese). Në internet: http://www.confeuconstco.org/reports/rep-xii/Liechtenst ein-EN.pdf (shikuar në 2022); Cf. po ashtu edhe **në European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission),** *The Composition of Constitutional Courts*, paragrafi 2.1 ["Eligibility Requirements"].

256 Neni 4 ["Kushtet shtesë për emërimin e gjyqtarëve "] i **Ligjit nr. 03/L-12:**
"1. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të jenë:
1.1. shtetas të Republikës së Kosovës;
1.2. jurist të shquar me reputacion të shkëlqyeshëm profesional me jo më pak se dhjetë (10) vjet përvojë pune profesionale veçanërisht në fushën e së drejtës publike dhe kushtetuese të dëshmuar, mes tjerash, përmes punës profesionale si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, shërbyes civil ose mësimdhënës universitar dhe punë tjera të rëndësishme të natyrës juridike;
1.3. individ me reputacion të shkëlqyeshëm moral, të cilët kanë aftësi të plotë veprimi dhe të cilët nuk janë dënuar për vepër penale".

257 Neni 114 ["Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese"] i Kushtetutës:
"1. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë (9) gjyqtarë, të cilët do të jenë juristë të shquar dhe personalitete me moralin më të lartë, jo me më pak se dhjetë (10) vjet përvojë profesionale përkatëse. **Kualifikimet e tjera përkatëse rregullohen me ligj.** Parimet e barazisë gjinore do të respektohen […]".

shtesë për të qenë gjyqtar kushtetues, si dhe standarde shtesë lidhur me organizimin e jetës dhe punës në **GJKRKS.**

Në **GJKRKS** kanë qenë tre gjyqtarë ndërkombëtarë (2009-2018). Kushtet për zgjedhjen e tyre i ka caktuar dhe vlerësuar vetë faktori ndërkombëtar në Kosovë. Kjo është arsyeja që në këtu shumë pak mund të tregojmë për kredencialet e tyre akademike dhe morale/etike. Përzgjedhja e tyre është bërë në mënyrë jo transparente dhe pa ndonjë dijeni të publikut kosovar.[258] Baza juridike për një procedurë të tillë ka qenë e përcaktuar fillimisht me **Planin Ahtisari**,[259] bazë e cila më pastaj është transformuar në bazë kushtetuese[260] dhe ligjore.[261] Kjo ka vlejtur edhe pas vitit 2012, kur u mbyll pavarësia e mbikëqyrur e Kosovës, kur një amendament kushtetues kosovar ka shërbyer si bazë për vazhdim për dy vitet në vijim të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtar në **GJKRKS**.[262] Amendamentimi në fjalë nuk ka pasur më këtë rol në qershorin e vitit 2014: amendamenti i vitit 2012 ka folur vetëm për vazhdim të mandatit për kohën e mbetur shtesë të personave të emëruar nga **PCN**; më vonë, në qershor të vitit 2014, mandati i gjyqtarëve kushtetues ndërkombëtar është vazhduar përmes teknikave të tjera juridike, të njohura si **letërkëmbimet**. E përbashkëta e shkëmbimit të letrave dhe amendamentit kushtetues, si bazë për caktim të gjyqtarëve ndërkombëtarë, qëndron në atë se, në dy rastet synohet shmangia, anashkalimi i Kuvendit si propozues i gjyqtarëve kushtetues. Sikundër dihet, propozimi

---

258 Më 12 qershor 2009, Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar **(PCN)** emëroi tre gjyqtarë ndërkombëtarë në Gjykatë për një periudhë trevjeçare. Cf. Vendimi Nr. 2009/09, Vendimi Nr. 2009/10 dhe Vendimi Nr. 2009/11, të cilat gjenden në akrivën e **Gjykatës Kushtetuese.** Këta gjyqtarë kanë qenë, sipas senioritetit: **Robert Carolan**, **Almiro Rodrigues** dhe **Snezhana Botusharova**.Në literaturë është vërejtur se prezenca e tyre ka qenë paraparë me qëllim të frenimit dhe pengimit të impulsive anti-minoritare të gjyqtarëve vendor: tre gjyqtarë ndërkombëtar dhe dy vendor nga komunitetet kanë qenë vota shumicë kundrejt gjyqtarëve shqiptarë. Kjo, megjithatë, me kalimin e kohës, nuk doli të jetë kështu: asnjë vendim në gjashtë vitet e para sa ka qenë kryetar i Gjykatës autori i parë të këtij libri nuk ka pasur vendime ku janë ndarë votat përgjatë vijave etnike apo në linjën **vendorë vs. ndërkombëtarë**. Cf. Steven Hill & Paul Linden-Retek, "Supervised Independence and Post-Conflict Sovereignty: The Dynamics of Hibridity in Kosovo's New Constitutional Court". *The Yale Journal of International Law Online* Vol. 36 (Fall 2010), fq. 26-43 në fq. 35-36, 39-41, si dhe fusnotën nr. 44 në fq. 35 (ku citohen vendimet për emërimin e tre gjyqtarëve ndërkombëtar si më sipër). Cf. edhe Andrea Lorenzo Capussela, "A Critique of Kosovo's Internationalized Constitutional Court". *European Diversity and Autonomy Papers*. **EDAP** 02/2014, fq. 5-41 në fq. 5-6. Në internet: www.eurac.edu/edap (shikuar në prill 2022) (ku autori mbron tezën, pa ndonjë provë të prekshme, sipas së cilës gjyqtarët ndërkombëtarë në **GJKRKS** kanë shëbryer për të zgjatur jetën pranisë ndërkombëtare në Kosovë, përkatësisht për të zgjatur pavarësinë e mbikëqyrur në Kosovë); Andrea Lorenzo Capussela, *State – Building in Kosovo. Democracy, Corruption and the EU in the Balkans* (I.B. Tauris: London and New York, 2015) fq. 164.

259 **Plani Ahtisari**.

260 Neni 152. 4 & 5 ["Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese "] i Kushtetutës:
Deri në fund të mbikëqyrjes ndërkombëtare të zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, Gjykata Kushtetuese do të përbëhet si në vijim:
"[...] 4. Tre (3) gjyqtarë ndërkombëtarë do të emërohen nga Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil pas konsultimit me Kryetarin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Tre (3) gjyqtarët nuk do të jenë qytetarë të Kosovës dhe as të ndonjë vendi fqinj.
5. Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil do të përcaktojë se kur skadon mandati i gjyqtarëve ndërkombëtarë, dhe gjyqtarët do të ndërrohen sikur është e parashikuar me Kushtetutë".

261 Kreu IV - Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare - Neni 55 ["Përbërja e përkohshme e Gjykatës Kushtetuese "] i **Ligjit nr. 03/L-121**:
"1. Për periudhën e përcaktuar në nenin 152 të Kushtetutës, përbërja e Gjykatës kushtetuese do të jetë sikurse është përcaktuar në atë nen.
2. Asgjë në këtë ligj, përfshirë dispozitat të cilat rregullojnë kriteret për përshtatshmëri, kualifikime profesionale dhe kompensim për gjyqtarët, nuk aplikohen për të penguar apo ndryshe kufizuar kompetencat dhe përgjegjësitë e autoriteteve kompetente për emërimin e gjyqtarëve ndërkombëtar, të përcaktuar në Kushtetutën dhe Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Republikës së Kosovës, të datës 26 mars 2007. Këto përgjegjësi dhe kompetenca ushtrohen në pajtim me instrumentet e aplikueshme pavarësisht ndonjë dispozite të këtij ligji".

262 Amendamenti kushtetues nr. **22**, miratuar me **Vendimi i Kuvendit të Republikes së Kosovës**, nr. 04- V- 436 të datës 7 shtator 2012, *Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20 dt. 5 gusht 2015,* ka përcaktuar si vijon:"Individët e emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombetar, në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit te Kosovës, të datës 26 mars 2007, mandati i të cileve nuk ka përfunduar para deklarimit të përfundimit të pavaresisë se mbikëqyrur do të vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre në institucionet ku janë deri në fund të mandatit të specifIkuar. Kosova do t'u japë ketyre individeve të njëjtat privilegje dhe imunitete që i gëzojnë diplomatët dhe familjet e tyre sipas Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike".

në Kuvend kryhet me zgjedhje (votim). Në rastin e parë, shmangia e procedurave vendore për caktim të gjyqtarëve ndërkombëtar ka qenë e plotë sepse është anashkaluar në tërësi procedura e zgjedhjes në Kuvend dhe procedura e emërimit (dekretimit) nga Presidenti i Republikës. E kemi fjalën për kohën e pavarësisë së mbikëqyrur dhe caktimin e gjyqtarëve ndërkombëtarë nga viti 2009-2012, si dhe rimandatimin e tyre për dy vitet në vijim (2012-2012). Në rastin e dytë, nga viti 2012 deri në vitin 2018, anashkalimi nuk është i plotë: përmes letërkëmbimit bëhet vetëm anashkalimi i Kuvendit, si propozues i gjyqtarëve kushtetues përmes zgjedhjes (votimit), duke ruajtur procedurën e emërimit (dekretimit) nga ana e **presidentit të Kosovës**.

Dispozitat e **Planit Ahtisari** që kanë të bëjnë me zgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve ndërkombëtar, bëjnë pjesë në ato dispozita juridike të cilat i ka shkelur koha dhe i takojnë historisë kushtetuese të Kosovës. Si të tilla, ato kanë qenë dispozita mjaft të detajuara dhe nuk kanë lënë vend për ndonjë dykuptimësi sa i përket fizionomisë hibride të gjyqësisë kushtetuese **kelseniane/evropiane** që parashikohej të instalohej në **Kosovë** pas fitimit të pavarësisë. Në to parashikohej caktimi i tre gjyqtarëve ndërkombëtarë, duke anashkaluar Kuvendin e Kosovës, i cili bën propozimin e gjyqtarëve kushtetues përmes zgjedhjes, si dhe presidentin, i cili në fund bën emërimin (dekretimin) e tyre formal. Këto dispozita lidhur me caktimin e gjyqtarëve ndërkombëtar, megjithatë, nuk i kanë dhënë **GJKRKS** një fizionomi **kelseniane/evropiane**: ato vetëm kanë shtuar një cilësi dalluese duke e bërë **një gjykatë kushtetuese hibride**. Kanë qenë dispozitat e tjera të aneksit I të **Planit Ahtisari** ato që kanë ngërthyer dispozita kushtetuese përmes së cilave, përfundimisht, në Kosovë është siguruar futja e modelit **kelsenian/evropian** të gjyqësinë kushtetuese pas fitimit të pavarësisë së vendit. E kemi fjalën këtu për dispozitat e pikave dy dhe tre të nenit 6 të aneksit I të Planit, që përcaktonin si vijon:

"[…] 6.2 Dhjetë apo më shumë deputetë të Kuvendit, mes tjerash, do të kenë të drejtën që të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji apo vendimi të miratuar nga Kuvendi para Gjykatës Kushtetuese, si në aspektin përmbajtësor ashtu edhe në atë procedural.

6.3. Komunat mund të kontestojnë para Gjykatës Kushtetuese, kushtetutshmërinë e ligjeve apo akteve të qeverisë të cilat cenojnë përgjegjësitë e tyre apo zvogëlojnë të hyrat e tyre".

Ky përcaktim i **Planit Ahtisari**, krahas përcaktimit tjetër të po këtij neni që bënte fjalë për kushtin që duheshin plotësuar kandidatët për t'u zgjedhur gjyqtarë kushtetues, përbën, në fakt, vetë esencën e modelit **kelsenian/evropian** të gjyqësie kushtetuese, përkatësisht cilësinë e përbashkët të të gjitha formave të manifestimit të **modelit kelsenian/evropian** të gjyqësisë kushtetuese. Përveç kontrollit abstrakt të normës juridike dhe kushtit themelor të të qenit jurist për t'u zgjedhur gjyqtar kushtetues, dhe që paraqiten si cilësi të njëjta në modelet **kelseniane/evropiane** të gjyqësisë kushtetuese, ekziston edhe një tjetër cilësi e përbashkët e kësaj gjyqësie. Ajo ka të bëjë me ngjashmërinë e kushteve nën të cilat ekziston dhe vepron gjyqësia **keseniane/evropiane**. Kjo është një cilësi shumë e rëndësishme e përbashkët e formave të manifestimit të modelit **kelesnian/evropian** të gjyqësisë kushtetuese.[263] Kjo cilësi, e cila ka natyrë ekzistenciale për një gjyqësi konkrete kushtetuese, ka të bëjë ngjashmërinë e kushteve nën të cilat krijohen dhe veprojnë gjykatat kushtetuese në shtetet konkrete veç e veç. Brendia e kësaj cilësie i referohet, në rend të parë, natyrës së sistemit qeverisës: gjykatat kushtetuese të tipit **kelsenina/evropian** kanë lindur dhe ekzistojnë në vendet që në të njëjtën kohë

[263] Louis Favoreu & Wanda Mastor, *Les cours constitutionnelles* (DALLOZ: Paris, 2016) fq. 19-28. Krahas këtyre dy cilësive të përbashkëta të krejt gjykatave kushtetuese, ekzistojnë edhe disa cilësi të tjera të veçanta që burojnë nga specifikat e secilit sistem kushtetues të përcaktuar me kushtetutë. Mundësinë e ekzistimit të dallimeve në mes të kompetencave konkrete brenda modelit **kelsenian/evropian** të gjyqësisë kushtetuese e ka parashikuar vetë **Hans Kelsen**. Nga një analizë e këtyre kompetencave konkrete, të përcaktuara me kushtetutë, lehtë mund të vërehen gjykatat kushtetuese që kanë kompetenca të privilegjuara, të cilat i bëjnë të dallueshme nga njëra tjetra. Në këtë drejtim duhen veçuar cilësitë e veçanta, ta zëmë, të **Gjermanisë**, **Italisë** dhe **Austrisë**: **GJKGje** njihet për **ankesën e saj të plotë kushtetuese** dhe rekordin në vendimmarrje në procedurat sipas ankesës kushtetuese në fushën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut; **GJKIt** ka një cilësi të kundërt me këtë: vendimmarrja shumë e sofistikuar e **GJKIt** në fushën e **kontrollit incidental** kalon çdo gjykatë tjetër në **Evropë** dhe e bën kampion në këtë aspekt; **Austria** me gjykatën e saj kushtetuese ka një cilësi po ashtu të veçantë, kontrollin kushtetues të akteve administrative, diçka që nuk përcaktohet në rastin italian dhe gjerman. Nuk ka asnjë dyshim që e njejta vlen edhe për Spanjën dhe Francën: **amparo** spanjolle paraqet një kompetencë e veçantë që dominon pjesën dërrmuese të punës së **Gjykatës Kushtetuese së Spanjës (GJKSp)**; kontrolli gjysmë-këshillëdhënës i **KKFr** në çështjet e zgjedhjeve nacionale dhe të zgjedhjeve për president, si dhe kompetenca e kontrollit preventiv të normave ligjore përbëjnë cilësitë e dallueshme të gjyqësisë kushteteuse franceze. Mund të citohen shembuj të panumërt këtu që vërtetojnë këtë që e thamë më sipër. Cf. më shumë në Ibid., fq. 28-38 & 128.

kanë një sistem parlamentar (ta zëmë, **Belgjika**, **Gjermania, Italia**, **Spanja,** etj.) ose gjysmë-parlamentar (**Austria**, **Franca**, **Portugalia**, etj.) dhe një pluralizëm të juridiksioneve.

Austria, **Belgjika**, **Franca**, **Italia**, **Portugalia** dhe **Spanja** kanë dy rende të juridiksioneve (gjyqësor dhe administrativ), **Greqia** tre sosh, kurse **Gjermania** pesë.[264] Në këto vende, në krye të secilit juridiksion ekziston një gjykatë supreme apo gjykatë e lartë e fundit në hierarkinë respektive brenda juridiksionit përkatës. Në këtë kontekst duhet parë gjykatat kushtetuese në vendet e demokracive kushtetuese perëndimore të proveniencës liberale, si organe shtetërore të ndara nga këto juridiksione dhe nga çdo organ tjetër shtetëror, dhe të veshura me një juridiksion ushtrimi i të cilit ka për qëllim primar dhe të vetëm sigurimin e epërsisë së kushtetutës dhe sigurimin e respektit të saj nga të gjitha juridiksionet dhe organet tjera shtetërore. Kjo ndarje e juridiksionit kushtetues nga juridiksionet tjera bëhet vetëm përmes përcaktimit shprehimor kushtetues, i cili ua njeh gjykatave të veçanta kushtetuese autorizimet e plota dhe të padelegueshme për kontroll kushtetues të punës së organeve të tjera shtetërore. Kjo nuk mund të vije si rezultat i një praktike gjyqësore, siç ka ndodhë në **Britaninë e Madhe** (1602) apo **SHBA** (1803), por vetëm me një sanksionim të qartë me kushtetutë të këtij autorizimi, i cili më pastaj mund të zgjerohet nga praktika gjyqësore kushtetuese. Baza e këtij përcaktimi kushtetues duhet të jetë shumë e qartë dhe të përfshijë tri aspekte bazike: organizimin, funksionimin dhe vetë kompetencat konkrete të gjykatës nacionale kushtetuese. Këto tri aspekte presupozojnë ekzistimin e dispozitave të domosdoshme kushtetuese lidhur me garancionet për pavarësinë organizative, administrative dhe financiare të institucionit që kryen funksionet e gjyqësisë kushtetuese dhe që quhet gjykatë/ tribunal/këshill kushtetues, si dhe të dispozitave të tjera të qarta që kanë të bëjnë me pavarësinë e anëtarëve të këtij institucioni. Tani të kthehemi sërish të çështja e caktimit të gjyqtarëve kushtetues.

Dispozitat e **Plani Ahtisari**, përveç kushtin e të qenit jurist, kanë qenë të heshtura sa i përket kushteve të tjera materiale, të cilat gjyqtarët vendorë dhe ndërkombëtar është dashur t'i plotësojnë për t'u bërë gjyqtarë kushtetues. Neni 6 i Planit ka pasur vetëm një dispozitë që ka folur për gjyqtarët ndërkombëtarë, dispozitën e nenit 6.1.3, e cila tregonte identitetin e autoritetit emërues të tyre.[265] Në fakt, ai ka pasur një dispozitë të ngjashme edhe për gjyqtarët vendor.[266] Saktësimi i kushteve të tjera materiale që është dashur t'i plotësojnë kandidatët për gjyqtarë, vendorët dhe ndërkombëtarët, bëhej me **KKos** dhe **Ligjin nr. 03/L-121**. Sa i përket gjyqtarëve vendorë, në **Kosovë** në tërësi vlejnë dispozitat e **KKos** dhe të **Ligjit nr. 03/L-121** që normojnë zgjedhjen, statusin dhe mandatin e gjyqtarëve kushtetues. Kjo ka qenë kësisoj që nga dita e parë e hyrjes në fuqi të **KKos** dhe të **Ligjit nr. 03/L-121.** Amendamenti kushtetues nr. **22**[267] ka kaluar kontrollin kushtetues (preventiv) të **GJKRKS**.[268] Si i tillë, ai ka qenë pjesë e amendamenteve kushtetuese me të cilat është mbyllur pavarësia e mbikëqyrur e **Kosovës**.[269] Ai ka ndërtuar një bazë të re

264 Louis Favoreu & Wanda Mastor, *Les cours constitutionnelles* (DALLOZ: Paris, 2016), fq. 19-25.

265 Neni 6.1.3. ["Gjykata Kushtetuese dhe Sistemi i Drejtësisë"] i **Planit Ahtisari**: "[…] Tre gjyqtarë ndërkombëtarë do të emërohen nga Kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut pas këshillimit me Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar".

266 Neni 6.1.1["Gjykata Kushtetuese dhe Sistemi i Drejtësisë"] i **Planit Ahtisari**: "[…] 6.1.1 Gjashtë (6) gjyqtarë do të emërohen nga Kryetari me propozim të Kuvendit. Nga gjashtë gjyqtarët e emëruar për mandatin e parë, pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, dy (2) gjyqtarë do të shërbejnë për një mandat trevjeçar pa mundësi të rizgjedhjes, dy (2) gjyqtarë do të shërbejnë për një periudhë gjashtëvjeçare pa mundësi të rizgjedhjes dhe dy (2) gjyqtarë do të shërbejnë për një periudhë nëntëvjeçare pa mundësi të rizgjedhjes. Më tutje, çdo gjyqtar i emëruar në Gjykatën Kushtetuese do të emërohet për një mandat nëntëvjeçar pa mundësi të rizgjedhjes. Gjyqtarët, mandati i të cilëve pritet të skadojë në fund të periudhës fillestare prej tre apo gjashtë vjetësh, do të zgjidhen me short nga Kryetari i Kosovës menjëherë pas emërimit të tyre".

267 Cf. fusnota nr. 262, **supra**, në këtë pjesë, si dhe teksti që e shoqëron.

268 *Arasti KO 38/12. Aktgjykim. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Propozimeve të Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës, të dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës më 12 prill 2012*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Nr. ref.:AK 234 /12. Prishtinë, më 15 maj 2012.

269 Cf. **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**. **Aneks: Amendamentet I – XXII Amendamentimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare te pavarësisë së Kosovës**.. *Vendimi i Kuvendit të Republikes së Kosovës, nr. 04- V- 436 të datës 7 shtator 2012. Gazeta Zyrtare e Republikës*

kushtetuese të përkohshme për vazhdimin e mandatit të tre gjyqtarëve kushtetues ndërkombëtarë. Këta gjyqtarë janë emëruar për herë të parë nga **PCN**, bazuar në dispozitat tanimë të shtjelluara të **Planit Ahtisari**.[270] Kjo bazë kushtetuese, siç vërehet nga formulimi i amendamentit të sipërcekur, ka qenë e njëjtë për të gjithë personelin e misionit **EULEX-it** nëpër gjykata të rregullta, prokurori, autoritete dhe organe të tjera kushtetuese dhe agjenci të pavarura në të cilat kanë qenë të atashuar për të punuar (të tilla kanë qenë, ta zëmë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Agjencia e Pronës e Kosovës, Agjencia e Privatizimit e Kosovës etj). Në këtë kuadër hyn edhe emërimi i gjyqtarëve ndërkombëtarë në **GJKRKS**, si dhe i këshilltarëve ndërkombëtarë ligjorë: të gjithë janë emëruar me vendime të veçanta individuale nga ana e **PCN**, në vijim të implementimit të bazës së re kushtetuese të ndërtuar me amendamentin e sipërcekur nr. **22**. Ky amendament, sikundër u pa më sipër, përcaktonte se do t'u vazhdohej mandati atyre të cilëve ende nuk u kishte skaduar ai i dhënë më parë nga ana e **PCN**. Për të qenë brenda kushteve të parashikuara me amendamentin nr. **22** si më sipër, **PCN** kishte bërë emërimin e gjyqtarëve ndërkombëtarë në **GJKRKS** para hyrjes në fuqi të këtij amendamenti,[271] njëjtë siç kishte bërë me stafin tjetër. Këta të emëruar, si në **GJKRKS** ashtu dhe në organet dhe agjencitë e tjera shtetërore (gjyqësi e rregullt, prokurori shtetërore, agjenci të pavarura dhe organe tjera shtetërore) kanë pasur statusin e stafit të **EULEX**-it, me imunitete dhe privilegje diplomatike përkatëse në mënyrën e përcaktuar me Konventën e Vjenës për Marrëdhënie Diplomatike (**KVMD**).

Pas pavarësisë së mbikëqyrur, ka pasur disa dështime për caktim të gjyqtarëve të rinj vendorë. Siç u tha më sipër, kushtet për caktimin e gjyqtarëve kushtetues dhe mandati i tyre përcaktohen me Kushtetutë, me **Ligjin nr. 03/L-121** dhe me **RrP.** Sa i përket mënyrës së caktimit të gjyqtarëve kushtetues, **Kosova** i takon **modelit të zgjedhjes**. Në këtë model, organi përfaqësues ka fjalën kryesore në caktimin e gjyqtarëve të gjykatës kushtetuese. Një procedurë e tillë, megjithatë, vlen vetëm sa i përket caktimit të gjyqtarëve vendorë: për gjyqtarët ndërkombëtarë, gjatë tërë kohës sa kanë qenë anëtarë të **GJKRKS**, sikundër u pa, ka vlejtur një version **sui generis** i **modelit të caktimit të drejtpërdrejtë**. Kjo për faktin se ata janë caktuar me emërim nga ana e **PCN** (2009-2014), përkatësisht nga ana e shefit të shtetit të kosovar (2014-2018), pa ndarë këtë autorizim për caktimin e tyre me asnjë organ tjetër, qoftë me **GJED-NJ** apo **Kuvendin e Kosovës**.

Në rastin e gjyqtarëve vendorë, ndërkaq, procedura e **modelit të zgjedhjes**, e definuar si më sipër, normohet me nenin 114.2 të **KKos** që flet për p**ërbërjen dhe mandatin e gjyqtarëve kushtetues. Në këtë nen thuhet** se "Gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Kuvendit, për një mandat nëntëvjeçar, pa mundësi vazhdimi". Sikundër shihet, në rastin e **Kosovës** nuk ekziston modeli i bashkëpunimit të organit përfaqësues dhe shefit të shtetit. Kjo nga shkaku se ky i fundit bën vetëm emërimin (dekretimin) tërësisht ceremonial të gjyqtarëve të zgjedhur nga Kuvendi. Ky sistem garantohet me **KKos**, e cila në mënyrë të qartë flet për këtë. Procedurat e vënies në jetë të këtyre dispozitave kushtetuese, të cilat garantojnë dhe sanksionojnë këtë **model të zgjedhjes** në **Kosovë**, specifikohen tutje në dispozitat e **Ligjit nr. 03/L-121**: me propozim të Kuvendit,[272] i cili voton për kandidatët nga lista e përzgjedhur për postin e gjyqtarit kushtetues nga ana komisionit **ad hoc**, Presidenti i Republikës bën

së Kosovës nr. 25 datë 7 shtator 2012.

270 Sikundër është thënë më sipër, mënyra e caktimit të tyre dhe kriteret që ata i kanë plotësuar, pos të qenit jurist, ngelen sot e kësaj dite një mister. Kjo për shkak se procesi i caktimit të tyre në **GJKRKS** asnjëherë nuk ka qenë transparent (është kryer jashtë syrit të publikut kosovar); Për komentet rreth personalitetit të këtyre gjyqtarëve, cf. më shumë në librin e njërit prej zyrtarëve të lartë ndërkombëtar që kanë punuar në Kosovë: Andrea Lorenco Capussela, *State – Building in Kosovo. Democracy, Corrpution and the EU in the Balkans*, fq.164-165, 174,176 (autori me tone jashtëzakonisht negative flet për gjyqtarët ndërkombëtar, në veçanti për gjyqtarin **Robert Carolan**, të cilin e paraqet si të politizuar, të anshëm dhe joprofesional; për gjyqtarët vendorë thotë se kanë qenë të rebeluar dhe kanë ndjekur sentimentin popullor mesatar me rastin e vendimmarrjes në rastet që kanë qenë të ndieshme për opinionin publik vendor, duke marrë si shembull rastin e rrëximit nga **GJKRKS** të **Behxhet Pacolli**-t nga posti i **Presidentit të Kosovës**).

271 Me 17 korrik 2012, **PCN** nxori Vendimin Nr. 2012/17, Vendimin Nr. 2012/18 dhe Vendimin Nr. 2012/19, për riemërimin e gjyqtarëve ndërkombetarë deri më 31 gusht 2014. Vendimet gjenden në **Arkivën e GJKRKS**.

272 Neni 65.11 [Kompetencat e Kuvendit] i Kushtetutës: "Kuvendi i Republikës së Kosovës: […] (11) propozon gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese; […]".

emërimin (dekretimin) formal të tyre.[273] Konkursi është publik, kurse konkurrimet janë shumë liberale: nominimet për të konkurruar mund t'i bëjnë organet dhe institucionet e ndryshme, qeveritare dhe joqeveritare, si dhe vetë kandidatët që konkurrojnë (vetëkonkurrimi **sua sponte**).[274] Procedura që vë në jetë dispozitat e mësipërme kushtetuese për caktimin e gjyqtarëve kushtetues rregullohet vetëm më një nen, me nenin 6 ["Procedura për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese "] të **Ligjit nr. 03/L-121**.

Mandati i gjyqtarëve zgjatë nëntë (9) vjet, pa mundësi riemërimi.[275] Pamundësia e riemërimit përbën një standard të përhapur në shumicën e vendeve evropiane. Ky standard është vënë së pari në demokracitë tradicionale të **Evropës**, në kohën e ndërtimit të gjykatave të tyre kushtetuese pas **Luftës së Dytë Botërore**.[276] Ai është vënë në jetë përmes dispozitave shprehimore kushtetuese. Kjo më pastaj është bartur edhe në vendet tjera të Evropës, në veçanti pas rënies së komunizmit dhe përqafimit të **modelit evropian/kelsenian** të gjyqësisë kushtetuese në këto vende. **Kosova** nuk bën përjashtim në këtë drejtim dhe ndjek modelin e shumicës së vendeve ish-komuniste. Kur një gjyqtari kushtetues i mbaron mandati para mbarimit të mandatit të rregullt, emërimi i gjyqtarit të ri bëhet me mandat të plotë, pa të drejtë rizgjedhjeje.[277] Kjo nënkupton se emërimi para kohe i një gjyqtari kushtetues për vendin e mbetur vakant duhet të bëhet sipas të njëjtës procedurë. Vlen të theksohet se kjo dispozitë kushtetuese, dhe të tjerat që nuk lejojnë mundësinë e rikandidimit të serishëm të një gjyqtari pas mbarimit të mandatit, përbën një standard të rëndësishëm që ndihmon në ruajtjen e pavarësisë së gjyqtarit kushtetues. Nga përvoja e tillë shihet qartë se pavarësia e gjyqtarëve sigurohet dhe garantohet më shumë në rastet kur gjyqtari kushtetues nuk ka nevojë të vrasë mendjen e vet nëse do të caktohet sërish në postin e njëjtë. Pamundësia e kandidimit të serishëm në literaturë gjerësisht konsiderohet si një kusht shumë i fortë i pavarësisë së gjyqtarit kushtetues.[278] E kundërta e kësaj, sistemi që mundëson ripërtëritjen e mandatit gjyqësor, shihet

273 Neni 84. 19 [Kompetencat e Presidentit] i Kushtetutës: "Presidenti i Republikës së Kosovës: […] (19) emëron gjyqtarët për Gjykatën Kushtetuese, me propozimin e Kuvendit; […]".

274 Neni 6.6 ["Procedura për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese "] i **Ligjit nr. 03/L-121**: "[…] 6. Procedurën për përcaktimin e listës së ngushtë të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese e fillon Komisioni. Komisioni publikon thirrjen/ftesën në media të shkruara dhe elektronike duke përfshirë edhe ato të cilat kryesisht lexohen nga komunitetet që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës, të Kuvendit, institucioneve gjyqësore, fakulteteve juridike, Odës së Avokatëve, shoqatave të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, partive politike, personave të tjerë relevant juridik dhe individëve që të propozojnë kandidat për zgjedhjen e një apo më shumë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë ftesa/thirrja). **Një person mund të propozojë veten për kandidat**. […]".

275 Neni 114.2 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] i Kushtetutës: "[...] 2. Gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Kuvendit, për një mandat nëntëvjeçar, pa mundësi vazhdimi [...]".

276 Në **Rusi,** gjyqtarët kushtetues kanë mandat 12 vjet, pa mundësi riemrimi. Kështu është në shumicën e vendeve evropiane. Në një skaj të rrallë gjendet përvoja e **Çekisë**, ku gjyqtarët kanë të drejtën për riemërim. Cf. Amy J. Weisman, "Separation of Powers in Post-Communist Government: A Constitutional Case Study of the Russian Federation". *American University International Law Review* Vol. 10 Issue 4 (1995) fq. 1365-1398 në fq. 1391, fusnota 164; Ryszard Cholewinski, "The Protection of Human Rights in the New Polish Constitution". *Fordham International Law Journal*. Vol. 22 Issue 2 (1998), fq. 235-291 në fq. 286-287 (autori flet për historinë kushtetuese të vendit në sferën e të drejtave të njeriut dhe në fund për **Tribunalin Kushtetues të Polonisë**; ky organ i gjyqësisë kushtetuese sipas të a.q. **Kushtetutës së Vogël** të vitit 1992 dhe Kushtetutës së vitit 1998, aktualisht në fuqi, përbëht prej 15 anëtarve, por mandati i tyre është nëntë vjet pa mundësi riemërimi); Rett R. Ludwikowski, "Constitutional Culture of the New East-Central European Democracies". *Georgia Journal of International & Comparative Law*. Vol. 29 No 1 (2000) fq. 1-29 në fq. 24; Zdeněk Kühn, "The Constitutional Court of the Czech Repoublic". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* (Cambridge University Press: Cambridge, 2017) fq. 199-236 në fq. 208.

277 Cf. Neni 114. 4 ["Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese "] i **KKos**.

278 Wojciech Sadurski, *Rights before Courts. A Study of Constitutional Courts in Postcommunist States of Central and Eastern Europe* (Springer: Dordrecht, 2005) fq. 14-15 e tutje (autori mbron tezën se pavarësia e gjyqtarit kushtetues forcohet në vendet që nuk lejojnë riemërimin; sistemi i mosemërimit, i cili sot është i përkrahur në shumicën e vendeve të Evropës dhe më gjerë, thotë ky autor, nuk është vetë për veti garancion i pavarësisë së një gjyqtari kushtetues: kjo është kështu sepse ka raste kur gjyqtarët kushtetues gjatë mandatit të tyre provojnë të bashkëpunojnë me politikën për t'i siguruar vetes një punë apo pozitë të mirë pas mbarimit të mandatit; sidoqoftë, mosemërimi përbën një faktor të rëndësishëm të pavarësisë së gjyqtarit kushtetues).

si një sistem që dëmton potencialisht pavarësinë e gjyqtarit sepse i njëjti person duhet të bëjë koncesione dhe të ketë çdo herë parasysh se çfarë mendon autoriteti emërues (pushteti politik) për punën e mëhershme gjatë mandatit të parë si gjyqtar.[279]

Zgjidhjet e bëra në **KKos**, të operacionalizuara tutje me **Ligjin nr. 03/L-121**, kanë natyrë kryesisht legalistike. Kjo nënkupton se i kushtohet rëndësi kushteve formale, plotësimi i të cilave mund të testohet përmes metodave juridike të vlerësimit që objektivisht mund të matet. Kjo qasje ndjek standardin e vendeve të tjera të botës demokratike që kanë gjykatë të ndarë kushtetuese sipas modelit **evropian/kelsenian**, pa marrë parasysh se cilin sistem të caktimit të gjyqtarëve kushtetues përqafojnë.[280] Kushti primar që gjykatat kushtetuese duhet ta plotësojnë është se

[279] Në vendet ku lejohet riemërimi, zakonisht mospëlqimi i vendimmarrjes së gjyqtarëve kushtetues gjatë mandatit të tyre të parë ka shërbyer si shkak imediat për mosemërim të tyre të serishëm. Cf. Zdeněk Kühn, "The Constitutional Court of the Czech Republic". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning,* fq. 199-236 në fq. 209.

[280] Sikundër mund të vërehet nga shtjellimet si më sipër në këtë seksion, sipas nenit 114.1 ["Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese"] të **KKos**, tri janë kushtet bazike sa i përket kandidatëve për pozitën e gjyqtarit kushtetues. Ato janë: një, që kandidati për gjyqtar kushtetues të jetë jurist i shquar, dy, që kandidati për gjyqtar kushtetues të ketë personalitet me moralin më të lartë, dhe tre, që kandidati për gjyqtar kushtetues të ketë jo më pak se 10 vjet përvojë pune. Në ndërkohë që kushti parë dhe tretë janë të prekshme dhe të matshme objektivisht, kushti i dytë përbën një vlerësim moralo-politik të deputetit të Kosovës në kontekstin e klimës së momentit kur votohet për kandidatin apo kandidatët konkret për gjyqtarë kushtetues. Plotësimi i kushtit në fjalë nuk mund të matet me kritere legalistike, por vetëm përmes kritereve vlerësuese që kanë natyrë ekstra legale, përfshirë ato të natyrës politike.Në nenin 4 ["Kushtet shtesë për emërimin e gjyqtarëve"] të **Ligjit nr. 03/L-121** janë vënë disa kushte shtesë, të cilat mund të thuhet se mund t'i shërbejnë Kuvendit si një parametër relativisht objektiv për vlerësim të kandidatëve që konkurrojnë për gjyqtarë kushtetues. Këta parametra janë relativisht objektiv në kuptimin juridik sepse me qartë dhe në mënyrë objektive e definojnë se cili duhet të jetë personaliteti i gjyqtarit të ardhshëm kushtetues. Në rend të parë, sipas dispozitës së nenit 4 paragrafi 1.pika 1.3 të **Ligjit nr. 03/L-121** kërkohet që personaliteti kandidatit për gjyqtar të plotësojë në mënyrë kumulative tri kushte: një, të ketë reputacion të shkëlqyeshëm moral, parametër ky i pastër ekstra-legal; dy, të ketë aftësi veprimi; dhe, tre, të mos jetë i dënuar. Këto tri kritere duhet të plotësohen në mënyrë çkumulative sepse, po u la që Kuvendi të vlerësoj vetëm në bazë të përshtatshmërisë morale të një kandidati, atëherë pashmangshëm ajo përshtatshmëri do të jetë moralo-politike. Kjo është kështu edhe për faktin se pak ka gjasa që një kandidat i dënuar të jetë me moral të përshtatshëm për një gjykatës kushtetues.

Në vijim si më sipër, ky vlerësim i këtyre tre parametrave si më sipër kryhet përmes votës në Kuvend, kur është fjala për modelin e **Kosovës**, përkatësisht përmes vendimit individual të organit qendror shtetëror që cakton gjyqtarin kushtetues, kur është fjala për modelet tjera të vendimmarrjes në kuadër të modelit **kelsenian/evropian** të gjyqësisë kushtetuese. Në kontekstin kosovar, shikuar në kuptimin e përgjithshëm, gjyqtarët kushtetues kërkohet që të propozohen nga një shumicë e kualifikuar parlamentare, e cila natyrshëm që është shumëfish më e lartë sesa shumica që zakonshëm komandon një qeveri e koalicionit. Propozimi që rrjedh nga Kuvendi, meqë duhet të mbërrijë shkallën prej 2/3 të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, është i prirur të jetë maksimalisht konsensual, në kuptimin që asnjë parti politike (apo as koalicioni që kontrollon qeveria) të mos mund ta votojë e vetme. Në këtë kuptim, propozimi për emërimin e gjyqtarëve kushtetues duhet që të jetë konsensual, dhe, natyrshëm, një vendim i tillë konsiderohet juridikisht si neutral dhe i pakontrollueshëm nga një parti apo koalicion i vetëm. Kjo rrethanë, në thelb, e bënë edhe më të besueshëm konstatimin tonë si më sipër se kushtet nga neni 4 të **Ligjit nr. 03/L-121** duhen plotësuar në mënyrë kumulative sepse ka pak gjasa që të jetë ndryshe meqë kërkohet një shumicë e tillë e kualifikuar e dy të tretave. Kjo, në fakt, përbën një garancion kushtetues që kandidatët e zgjedhur për gjyqtarë kushtetues të jenë figura konsensuale, në kuptimin që një shumicë e kualifikuar parlamentare t'i shohë si të denjë për ta ushtruar këtë funksion jashtë ndikimeve eventuale politike.Pas marrjes së propozimit të Kuvendit, Presidenti i Republikës **duhet** të bëjë emërimin e gjyqtarëve kushtetues. Pyetje me rëndësi për këtë kontekst është nëse Presidenti i Republikës mund të refuzojë një propozim të Kuvendit? Kushtetuta nuk jep ndonjë përgjigje të qartë për këtë, megjithatë, për aq kohë sa Presidenti i Republikës **vishet me të drejtën e emërimit,** natyrshëm që mund edhe ta ushtroj të drejtën e refuzimit të emrimit të një propozimi të Kuvendit. Në ushtrimin e kësaj të drejte, megjithatë, Presidenti i Republikës duhet të arsyetojë që një nga kushtet e kërkuara nga Kushtetuta për kandidatët për gjyqtar kushtetues nuk është zbatuar. Në të kundërtën, Presidenti është i detyruar ta bëjë emërimin sipas propozimit të Kuvendit. Kjo mundësi për refuzim të emrimit dhënë Presdientit bëhet edhe më e arsyeshme nëse kihet parasysh fakti se propozimet për kandidat nuk vijnë nga një trup profesional, siç është rasti, ta zëmë, me **Këshillin Gjyqësor** që propozon gjyqtarët e gjyqësorit të rregullt, por nga një organ krejtësisht politik, përfaqësues dhe jo profesional. Por, siç u cek, Presidenti duhet çdo refuzim ta arsyetoj deri në detaje meqë bëhet fjalë për një të drejtë kushtetuese individuale. Kjo nënkupton se çdo vendim i Presidentit për refuzim mund të përfundoj për kontroll gjyqësor të ligjshmërisë së tij sipas rregullave mbi konfliktin administrativ dhe, paralelisht, edhe në kontroll të kushtetutshmërisë së tij pranë **GJKRKS** sipas nenit 113.7 të Kushtetutës. U mor vesh, vendimi për refuzim mund të shkoj në

ato duhet të plotësojnë vendet vakante për gjyqtarë nga juristë të shkëlqyeshëm dhe profesionalisht të mirë në çdo lëmi juridike, si dhe në filozofinë e së drejtës. Kosova nuk bën një përjashtim në këtë drejtim sepse, sikundër u vërejt, kërkon që gjyqtarët e saj të jenë juristë të shquar. Ky është një kusht i matshëm me kritere objektive dhe bazohet në punën që ka kryer kandidati në të kaluarën dhe forcën intelektuale që ajo/ai e ka projektuar përmes botimeve nga lëmi juridik, në veçanti nga lëmi e të drejtës publike dhe filozofia se së drejtës. Në praktikë kjo përkthehet si diçka që **profesorëve universitarë** u jep gjasa më të mira për një përfaqësim të madh, në krahasim me kuadrot tjera që nuk vijnë nga jeta universitare. Në këtë përparësi përfshihen edhe punëtorët shkencorë të instituteve të ndryshme hulumtuese dhe shkencore, që kanë botuar gjerësisht në lëmin juridik dhe në sferat tjera të së filozofisë juridike. Kjo qasje ekziston edhe në vendet tjera ish-komuniste të **Evropës**, ku pjesëmarrja në gjyqësinë kushtetuese të profesorëve universitarë paraqitet si mjaft e dukshme.[281]

Për këtë arsye, në **Kosovë** dhe në modelin **kelsenian/evropian** në përgjithësi kërkohet një përvojë, së pakut, prej dhjetë vjetësh, duke i dhënë përparësi profesionit të profesorit universitar: përvoja dhjetëvjeçare në mësimdhënie, studime dhe hulumtime mjafton për të tejkaluar retorikën dogmatike që shoqëron sferat tjera të profesionit të juristit. Cilësia sipas së cilës kandidati për gjyqtar duhet të jetë një "jurist i shquar", që e kërkon **KKos**,[282] nënkupton që një kandidat të ketë vlera të larta profesionale në fushën e drejtësisë në përgjithësi. Duhet pasur parasysh që pozita gjyqtar kushtetues, në kuptim të vet rolit të gjyqësisë kushtetuese, nënkupton jurist të shquar, jo thjeshtë në aspektin teknik, siç mund të jenë gjyqtarët dhe avokatët e rëndomtë, por juristë të natyrës filozofike. Duhet thënë këtu që gjyqësia kushtetuese natyrshëm kërkon aftësi juridike jo thjeshtë të nivelit të teknikës së konstruksionit të normës, por edhe të natyrës filozofike dhe prapavijës teorike të normës kushtetuese. Kjo histori lidhur me strukturën profesionale të gjyqësisë kushtetuese nis me shtjellimin e parë dhe të plotë teorik të arkitektit të saj ideor, **Hans Kelsen**, i cili që në vitin e largët 1928, avokoi fuqishëm për vënien e profesorëve universitar në pozitat e gjyqtarëve kushtetues. Ai, për më tepër, me këtë rast ka propozuar që fakultetet juridike të bëjnë një komision të përbashkët të veçantë me qëllim të prezantimit të kandidatëve të tyre më të mirë për postin e gjyqtarit kushtetues, ashtu që më pastaj gjykata kushtetuese të ketë të drejtën e **kooptimit** nga mesi i profesorëve të propozuar nga një komision i tillë.[283] Shikuar më thellë, kjo qasje ka kuptim të plotë për dy arsye: e para, profesorët universitarë në parim janë më pak dogmatikë si pasojë e natyrës së punës që kryejnë; dhe, e dyta, natyra e dijes kushtetuese dhe e të drejtës publike në përgjithësi i bën profesorët universitarë më të përshtatshëm për këto pozita, nisur nga fakti se mësimi dhe studimi i vazhdueshëm që ata bëjnë, paraqet një barrierë të fuqishme kundër dogmatizmit të vendimmarrjes dhe mendjes së tyre.[284]

---

kontroll kushtetues edhe nga subjektët tjerë të privilegjuar nga neni 113. 2 (1) i **KKos**.

281 Në raste të rralla, në vendet ish-komuniste të **Evropës** numri i akademikëve në gjykatat kushtetuese ka qenë më i ulët se profesionet tjera. I tillë ka qenë rasti me **Republikën e Çekisë** në vitet e para pas pavarësisë. Kjo situatë në literaturë është shpjeguar me faktin se në tregun e punës nuk ka pasur akademikë të pakompromet uar në kohën e regjimit komunist cekosllovak. Cf. Zdeněk Kühn, "The Constitutional Court of the Czech Republic", fq. 209.

282 Neni 114.1 ["Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese "] i **KKos**:

"1. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë (9) gjyqtarë, të cilët do të jenë juristë të shquar dhe personalitete me moralin më të lartë, jo me më pak se dhjetë (10) vjet përvojë profesionale përkatëse. Kualifikimet e tjera përkatëse rregullohen me ligj. Parimet e barazisë gjinore do të respektohen. [...]".

283 Cf. Hans Kelsen, "La garantie juridictionnelle de la Constitution (La Justice constitutionnelle)". *Revue du Droit Public et de la Science Politique en France et à l'Étranger* (avril-mai-juin 1928), fq. 197-257. Vlen të theksohet që, megjithatë, **kooptimi** i gjyqtarëve kushtetues nuk përbën një standard në gjyqësinë kushtetuese të modelit **kelsenian/evropian**. Janë të rralla rastet kur kushtetutat parashikojnë këtë institut, siç është rasti me **Kushtetutën e Portugalisë** të vitit 1976, e cila lejon kooptimin e gjyqtarëve nga ana e atyre dhjetë gjyqtarëve që zgjidhen nga **Asambleja e Portugalisë** (pargrafi i parë i nenit 222 të Kushtetutës, i cili normon përbërjen dhe statusin e gjyqtarëve kushtetues). **Portugal's Constitution of 1976 with Amendments through 2005**. Në internet: https://www. constituteproject.org/constitution/Portugal_2005.pdf (shikuar në janar 2023).

284 Në **Kosovë** nuk kërkohet një moshë e veçantë për të qenë gjyqtar kushtetues. Në disa vende, për të qenë gjyqtarë kushtetues kërkohet një moshë e caktuar ashtu që pa përmbushjen e këtij kushti nuk mund të ushtrohet funksioni

Për të qenë gjyqtar kushtetues, diversiteti etnik, kulturor, gjuhësor dhe tjetër nuk përbën një kriter shprehimor e as ndonjë standard të përqafuar gjerësisht në **Evropë**.[285] Në Kosovë ky nuk është rasti: në **KKos** ka gjetur një vend të veçantë respektimi i diversitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe tjetër. Prej nëntë gjyqtarëve që ka **GJKRKS**, dy gjyqtarë propozohen nga shumica e deputetëve të pranishëm, pasi që të kenë marrë pëlqimin e shumicës së deputetëve që mbajnë **vendet që janë të garantuara** (sepse vendet e rezervuara më nuk ekzistojnë që nga fundi i pavarësisë së mbikëqyrur në shtator të vitit 2012) për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë. Kjo dispozitë kushtetuese, në mënyrë efektive detyron Kuvendin që të votojë cilindo kandidat që plotëson kushtet formale për gjyqtar kushtetues dhe që është rekomanduar nga **Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve në kuptim të nenit 78 (nën 3 &4) [Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve] të KKos**.

Krahas diversitetit etnik, gjuhësor, kulturor dhe tjetër si më sipër, diversitet që mbrohet në mënyrë te veçantë më dispozitat e kapitullit të III-të ["Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre"] të **KKos**, në Kosovë një peshë të veçantë ka edhe respektimi i barazisë gjinore. Edhe kjo përbën, njëjtë si barazia e komuniteteve kosovare, një postulat dhe parim kushtetues që përshkon tërë sistemin kushtetues kosovar dhe ka një rëndësi të posaçme: nuk është vetëm fjalia e fundit e dispozitës së nenit 114.1 të **KKos**, por tërë shpirti dhe fryma e rendit kushtetues kosovar bazohet në mosdiskriminim gjinor dhe mbi asnjë bazë tjetër. Sa i përket përfaqësimit regjional të pjesëve të caktuara të **Kosovës**, kjo nuk përbën një kusht për t'u zgjedhur gjyqtar kushtetues.[286]

Deri më tani folëm për zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues, e cila kryhet nga ana e një organi të jashtëm, **Kuvendi i Kosovës**. Këtu ngelet edhe një çështje tjetër që ka të bëjë me zgjedhjen dhe mandatin kushtetues të anëtarëve të **GJKRKS**. Fjalën e kemi për kryetarin dhe zëvendëskryetarin: neni 114.5 i **KKos** përcakton që ata zgjedhen nga vet gjyqtarët kushtetues, me anë të votimit të fshehtë, për një mandat trevjeçar. Për t'u zgjedhur kryetar dhe zëvendëskryetar kërkohet një shumicë e thjeshtë e votave të trupës gjyqësore. Zgjedhja në funksione drejtuese të **GJKRKS**, në të dy rastet, nuk mund ta shtyjë mandatin si gjyqtar, sipas të njëjtit paragraf të nenit 114. Në këtë kuptim, **KKos** hap rrugë për një autonomi të brendshme të **GJKRKS** sa i përket zgjedhjes së kryetarit të saj, duke mos lejuar participimin e aktorëve të tjerë shtetërorë në këtë përcaktim të brendshëm të saj.[287] Kjo duhet të shihet si një standard

i gjyqtarit kushtetues. Cf. Michaela Hailbronner and Stefan Martini, "The German Constitutional Court", fq. 265 (kërkohet mosha 40 vjet, krahas të qenit jurist i diplomuar me një përvojë të gjatë pune); András Jakab and Johanna Frölich, "The Constitutional Court of Hungary". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 394-437 në. fq. 405, fusnota nr. 27 (kërkohet mosha 45 vjet, krahas të qenit jurist i diplomuar me një përvojë të gjatë pune).

285 Zakonisht kjo përbën një kusht në vendet që kanë rregullim shtetëror federativ. Cf. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *The Composition of Constitutional Courts,* paragrafet 2.2 dhe 2.3.

286 Në disa vende, në **Austri** ta zëmë, tre nga dymbëdhjetë (12) gjyqtarët e **Gjykatës Kushtetuese të Austrisë** duhet të jenë nga rajonet jashtë **Vjenës**. Kjo, megjithatë, nuk diktohet nga diveristeti etnik, kulturor, gjuhësor dhe tjetër i këtij vendi por nga arsyet pragmatike: në literaturë thuhet se kjo bëhet për të garantuar strukturën federale të **Gjykatës Kushtetuese të Austrisë**. Cf. Konrad Lachmayer, "The Austrian Constitutional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 86; Vlen të theksohet, megjithatë, se në **Kosovë** përfaqësimi regjional **de facto** përbën një cilësi të praktikave të shëmtuara në fitimin dhe ushtrimin e posteve politike, përkatësisht në vënien e kuadrove nëpër vendet udhëheqëse profesionale: kërkimi i njerëzve nga regjioni i njëjtë me ata që janë në pushtet përbën një kusht të heshtur për fitimin dhe ushtrimin e një posti të caktuar. Lojaliteti regjional nuk duhet të jetë kriter as faktik e as ligjor, së paku jo në vendet me rregullim shtetëror unitar siç është **Kosova.**

287 Në këtë drejtim nuk ka një standard stabil dhe të qartë. Përvojat e vendeve lidhur me këtë dallojnë. Në disa vende, kryetarin e zgjedhin organeve tjera kushtetuese (parlamenti ose kryetari i shtetit). Në vendet tjera, zgjedhjen e bëjnë vetë gjyqtarët kushtetues. Mund të thuhet se zgjedhja nga brenda, përkatësisht nga vetë trupa gjyqësore paraqet një rrugë më të qëlluar dhe më të dëshirueshme sepse më shumë ka gjasë të sigurojë pavarësinë e gjyqësisë kushtetuese.
Në grupin e parë hyjnë shtetet si: **Azerbajxhani, Estonia, Gjermania, Lihtenshtajni, Polonia, Zvicra** (parlamenti), **Austria, Cekia, Finlanda, Franca, Japonia, Irlanda, Norvegjia, Kanada, Sllovakia, Spanja** (kryetari i shtetit). Në grupin e dytë, ndërkaq, hyjnë këto vende: **Argjentina, Belgjika, Bullgaria, Danimarka, Gjorgjia, Hungaria, Islanda, Italia, Latvia, Kroacia, Maqedonia, Portugalia, Rumania, Rusia, Sllovenia, Shqipëria, Turqia, Ukraina**. Zakonisht kërkohet një shumicë absolute, por ka raste kur kërkohen edhe dy të tretat e votave të gjyqtarëve kushtetues (**Portugalia**). Ka raste kur procedura

i pavarësisë, meqë nuk lejon hapësirë që emërimi i kryetarit dhe zëvendëskryetarit të bëhet me ndikim nga jashtë. Në kuptim të këtij paragrafi, emërimi i kryetarit dhe të zëvendëskryetarit bëhet me shumicën e votave të gjyqtarëve.

27.3. Statusi

Në këtë pjesë të këtij kapitulli diskutojmë tri aspekte përbërëse që janë përcaktues thelbësor të statusit të gjyqtarëve të **GJKRKS**. Ato janë kategoritë si vijon: **papajtueshmëria**, **privilegjet** dhe, në fund, **imunitetet**. Këto tri aspekte janë thelbësore për ruajtjen e pavarësisë objektive dhe integritetin e gjyqtarit kushtetues. Aspektet në fjalë, si të tilla, kanë natyrë institucionale dhe afektojnë pavarësinë e gjyqtarit në përgjithësi, përfshirë gjyqtarin kushtetues.

27.4. Papajtueshmëria

Dispozitat kushtetuese flasin për kualifikimet dhe cilësitë themelore që duhet t'i posedojnë gjyqtarët kushtetues, për barazinë gjinore si parim kushtetues që duhet të respektohet në çdo moment, duke ia lënë çështjen e kualifikimeve dhe cilësive të tjera shtesë **Ligjit nr. 03/L-121**. Kjo qasje kësisoj nuk përbën zgjidhjen më të mirë sepse, ka shumë rëndësi që kriteret lidhur me kualifikimet themelore, sikur ato që lidhen me papajtueshmërinë **objektive** (funksionale), të përcaktohen me tekstin kushtetues në mënyrë sa më të qartë dhe sa më hollësisht që të jetë e mundur. Sa më shumë që këto aspekte i lihen për rregullim ligjit organik dhe akteve të tjera me fuqi më të ulët se kushtetuta, të cilat normojnë organizimin dhe punën e gjykatës, aq më shumë shtohen gjasat për ndërhyrje të faktorëve ekstra-kushtetues dhe ekstra-ligjorë në vendimmarrjen e gjykatës kushtetuese. Papajtueshmëria **objektive** (funksionale), të cilën e diskutojmë në vijim, bën pjesë në këto kushte thelbësore që do të duhej të ishin të sanksionuara me tekstin kushtetues, jo me ligj. Në **Kosovë**, megjithatë, ky nuk është rasti: papajtueshmëria **objektive** (funksionale) përcaktohet me **Ligjin nr. 03/L-121,** kurse procedura e përjashtimit për shkak të konfliktit të interesit dhe pengimit të tij në një rast konkret përcaktohet edhe me **RP**. Në rastin e fundit, pra, fjala është për konflikt të interesit të një gjyqtari në raport më një rast konkret dhe përbën një çështje krejtësisht tjetër nga papajtueshmëria **objektive** (funksionale).

Në vijim si më sipër, papajtueshmëria në kuptimin **objektiv** (funksional) përcaktohet dhe normohet me **Ligjin nr. 03/L-121**, jo me **RP**, dhe atë vetëm me një nen të tij. Ai nen është neni 5 ["Papajtueshmëria e funksionit"], i cili bën fjalë për papajtueshmërinë **objektive** (funksionale) në një mënyrë mjaft të qartë. Nga katër paragrafët e këtij neni,[288] vetëm i treti me radhë mbulon situatat që kanë të bëjnë me

thjeshtëzohet në rast të dështimit të parë, siç është rasti me **Italinë, Portugalinë** dhe **Spanjën**. Në modalitete të çuditshme hyn rasti i **Armenisë,** ku kryetarin e zgjedh parlamenti. Nëse ai dështon ta bëjë një gjë të tillë, atëherë kjo e drejtë i kalon shefit të shtetit. Cf. European Commssion for Democracy Through Law (Venice Commission), *The Composion of Constitutional Courts,* paragrafi 3.1.

[288] Neni 5 ["Papajtueshmëria e funksionit"] i **Ligjit nr. 03/L-121:**
"1. Gjatë mandatit të tij gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk ka të drejtë të jetë:
1.1. anëtar i një partie, lëvizje ose çfarëdo organizate tjetër politike;
1.2. anëtar i bordit drejtues të një ndërmarrje publike, shoqërie tregtare ose organizate jo qeveritare;
1.3. anëtar i një sindikate;
2. Përveç ndalesave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk ka të drejtë të ushtrojë ndonjë detyrë tjetër publike apo profesionale për të cilën shpërblehet me pagesë, përveç ushtrimit të funksionit të ligjëruesit të shkencave juridike në një universitet të akreditуar. Për qëllime të këtij ligji, nuk konsiderohet detyrë publike apo profesionale nëse gjyqtari pa pagesë merret me veprimtari shkencore, apo pa pagesë angazhohet si anëtar në institute ose shoqata të juristëve, në organizata humanitare, kulturore, sportive dhe organizata tjera, përderisa këto aktivitete nuk kanë lidhje me punën e ndonjë partie politike;
[…];
4. Secili gjyqtar ka për detyrë të njoftojë Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese me shkrim për çdo aktivitet që kryen jashtë funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese për të cilën kompensohet me mëditje ose çfarëdo forme tjetër të kompensimit. Në rast se Kryetari i Gjykatës Kushtetuese shpreh kundërshtimin e vet, gjyqtari ka të drejtë të kërkojë që vendimi i Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të rishqyrtohet nga të gjithë gjyqtarët e

kohën para fitimit (pas zgjedhjes në Kuvend, por para emërimit nga presidenti) të pozitës së gjyqtarit kushtetues.[289] Situatat tjera të përshkruara në tre paragrafët tjerë kanë të bëjnë me kohën e mbajtjes dhe ushtrimit aktiv të funksionit të gjyqtarit kushtetues. Gjendja e papajtueshmërisë **objektive** (funksionale) duhet t'i referohet një pozite, funksioni apo pune që është aktuale dhe që reflekton konflikt me pozitën e në ardhje apo atë aktuale si gjyqtar kushtetues. Kjo do të thotë se, në parim, pozita, funksioni apo puna që nuk janë aktuale nuk mund të llogariten si një gjendje që e bën të papajtueshëm fitimin e pozitës së gjyqtarit kushtetues, si dhe ushtrimin e tij.[290] Këto pengesa që formojnë papajtueshmërinë kanë të bëjnë si me fazën e fitimit (zgjedhjen dhe emërimin) ashtu edhe me atë të ushtrimit aktiv të postit të gjyqtarit kushtetues. Thënë me fjalë të tjera, neni 5 flet si për papajtueshmërinë me rastin e fitimit të postit (zgjedhjes dhe emërimit) ashtu edhe gjatë kohës së të qenit gjyqtar kushtetues.

Pengesat që formojnë papajtueshmërinë, janë barriera **objektive** që përcaktohen në mënyrë të përgjithshme nga një normë dhe i shërbejnë pavarësisë së gjyqtarit dhe integritetit të tij, duke pasur për qëllim ruajtjen e natyrës së funksionit të gjyqtarit kushtetues. Këtë e ka konstatuar **GJKRKS** në njërin prej vendimeve të saj kur ka qortuar publikisht njërin prej gjyqtarëve të saj që kishte marrë pjesë aktive në një fushatë politike të organizuar nga njëra prej partive, **PDK** (**Partia Demokratike e Kosovës**).[291] Në shqiptimin e kësaj mase ndaj gjyqtarit kushtetues, **Kadri Kryeziu**, **GJKRKS** ka vënë theksin në arsyetimin e vet në rëndësinë që ka për pavarësinë e saj, ruajtja e imazhit të saj në publik dhe respektimin e një baraspeshe në mes të jetës së gjyqtarëve si qytetarë të zakonshëm dhe respektimit nga ana e tyre të kufizimeve për t'u marrë me disa aktivitete që janë në kundërshtim (apo të papajtueshme) me natyrën e gjyqtarit kushtetues.[292] Në këtë rast, **GJKRKS** ka bërë dallimin në mes të pavarësisë së gjyqtarit dhe

---

Gjykatës Kushtetuese. Vendimi i tillë mund të hidhet poshtë nga shumica e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese".

289 Neni 5 ["Papajtueshmëria e funksionit"] i **Ligjit nr. 03/L-121:**
"[…] 3. Gjyqtari i propozuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk mund të emërohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës nëse nuk paraqet dëshmi se ka dhënë dorëheqje nga funksionet e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni […]".

290 **Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë**, si shembull krahasues, theksoi se kandidatura e një anëtari të saj për president të Republikës Federale nuk e diskualifikon atë automatikisht nga ushtrimi i funksionit në Gjykatë Kushtetuese, e as nuk përbën **per t**ë bazë të mjaftueshme për ta vënë në dyshim paanshmërinë e tij. (Vendimi i **Gjykatës Kushtetuese të Republikës Federale të Gjermanisë** nr. 1BvR 1693/92 i datës 8 shkurt 1994). Teksti i plotë në internet: https://dejure.org/dienste/vernetzung/rechtsprechung?Gericht=BVerfG&Datum=08.02.1994&Aktenzeichen=1%20BvR%201693%2F92 (shikuar në janar 2023). **Gjykata Kushtetuese e Belgjikës** ka vendosur që pjesëmarrja e një deputeti në elaborimin e një ligji që është kontestuar panë saj, që konsiston në përkrahjen nga ana e gjyqtarit të shumicës parlamentare së cilës i përkiste duke votuar për ligjin dhe kundër amandamenteve të paraqitura nga opozita, nuk është arsyetim objektiv i mjaftueshëm për dyshimet e parashtruesve sa i përket aftësive të tij që si gjyqtar të shqyrtojë paanshmërisht kushtetutshmërinë e ligjit të kontestuar. *Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Belgjikës* nr. 35/94 i datës 10 maj 1994 (atëbotë quhej "Gjykata e Arbitrazhit", emërtim që është ndërruar me amendamentet kushtetuese të vitit 2007). Për përmbledhjen e tekstit të aktgjykimit në fjalë, cf. në *International Conference on "The Influence of the ECHR Case-Law on National Constitutional Jurisprudence"*. Kyiv, Ukraine, 13-16.10.2005. **Extracts from CODICES Database of the Venice Commission.** fq. 55. Në internet: http://www.venice.coe.int/files /courts%20 referring %20to% 20 the% 20 ECHR.pdf (shikuar në 2022).

291 *Rasti KK 124/14. Aktvendim. Hetimi për pretendimet e sjelljes jokushtetuese nga gjyqtari Kadri Kryeziu.* **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. ref.: 698/14. Prishtinë, më 20 gusht 2014, paragrafi 21:"[…] 21. Gjykata thekson që njëra nga garancitë e pavarësisë së Gjykatës Kushtetuese ndërlidhet me klauzolën e papajtueshmërisë, d.m.th. disa kufizime të caktuara që rrjedhin nga vetë natyra e funksionit kushtetues gjyqësor. Kjo i referohet aktiviteteve jashtëgjyqësore, qofshin ato publike apo private, të cilat në ndonjë mënyrë janë në papajtueshmëri me funksionin e të qenit gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese […]"

292 Ibid., paragrafi 22 :"[…] Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se gjyqtarët nuk duhet të jenë të izoluar nga shoqëria në të cilën jetojnë, pasi qe sistemi gjyqësor mund te funksionoje si duhet vetëm nëse gjyqtarët janë në kontakt me realitetin. Megjithatë, aktivitetet e tilla mund ta rrezikojnë paanshmërinë e tyre, apo ndonjëherë edhe pavarësinë e tyre. Prandaj, duhet të vendoset një baraspeshë e arsyeshme ndërmjet asaj se sa mund të përfshihen gjyqtarët në shoqëri, si dhe nevojës që ata të jenë dhe të konsiderohen si të pavarur dhe të paanshëm në kryerjen e detyrave të tyre. Në këtë drejtim, në kontekstin e caktuar social dhe në sytë e një vëzhguesi të arsyeshëm e të informuar, duhet të shikohet se a është angazhuar gjyqtari në një aktivitet i cili në mënyrë objektive do të mund ta cenonte pavarësinë apo paanshmërinë e tij. Nëse një gjyqtar është i pasigurt, Gjykata do të duhej t›i siguronte organet apo personat që kanë funksion konsultativ dhe këshillimor, dhe që janë në dispozicion të gjyqtarëve kurdo që ata kanë ndonjë pasiguri në lidhje me atë se a është një aktivitet i caktuar nga sfera private në pajtueshmëri me statusin e tyre si gjyqtar. Më tej, sa i përket pjesëmarrjes së gjyqtarëve në debate publike të një natyre politike, ata

vetë asaj si organ i gjyqësisë kushtetuese, në njërën anë, dhe paanësisë në vendimmarrje të gjyqtarëve kushtetues, në anën tjetër. Në ndërkohë që në rastin e parë flitet për kufizime të përgjithshme dhe parimore që kanë fuqi **objektive** veprimi, si në kohë ashtu dhe në hapësirë, në rastin e dytë bëhet fjalë për paanësinë e gjyqtarit si një gjendje **subjektive** që përcaktohet nga marrëdhënia e saj/tij me rastin apo palët në procedim e sipër. Kjo e dyta rregullohet, në rastin e **Kosovës**, në kuadër të kreut II të **Ligjit nr. 03/L-121** dhe rregullit 2 të **RrP** që kanë të bëjnë me procedurën në gjykatë dhe nuk ka të bëjë fare me natyrën **objektive** (funksionale) të pozitës së gjyqtarit kushtetues, siç është kufizimi që përbën papajtueshmërinë **objektive** (funksionale): përcaktues kryesor për konfliktin e interesit është marrëdhënia konkrete e një gjyqtari me rastin konkret dhe palët tjera në procedurë, pa marrë parasysh nëse gjyqtari kushtetues ka kontribuar apo jo në krijimin e rrethanave të tilla. Me fjalë të tjera, këtu flitet për **konflikt të interesit** të një gjyqtari kushtetues, jo për papajtueshmëri në kuptimin **objektiv** (funksional) në mes të pozitës si gjyqtar kushtetues dhe një pozite tjetër që nuk i shkon pozitës së gjyqtarit kushtetues. Kjo e dyta mund të lindë si para dhe pas fitimit (zgjedhjes dhe emërimit) të postit të gjyqtarit kushtetues ashtu edhe gjatë kohë së ushtrimit të këtij funksioni. Në fakt, në rastin e **konfliktit të interesit**, fjala është për marrëdhënie **subjektive** në mes të gjyqtarit, rastit dhe palëve, jo domosdo për ndonjë faj apo qëllim të gjyqtarit për ndërtim të një gjendjeje të tillë subjektive që potencialisht rrezikon paanshmërinë e saj/tij në vendimmarrje në një rast që aktualisht pret për t'u zgjidhur në gjykatë.

Në **Kosovë** angazhimi politik në të kaluarën nuk përbën një pengesë formale-juridike:[293] një rrethanë e tillë përbën barrierë dhe formon papajtueshmëri absolute vetëm gjatë kohës sa ajo/ai është gjyqtar kushtetues. Kjo u diskutua më sipër kur u tregua për rastin e gjyqtarit **Kadri Kryeziu**. Në parim, nga jurisprudenca komparative rrjedh se caktimi i ish-politikanëve është më i rrallë dhe paraqet një problem serioz. Këtu kemi parasysh në rend të parë vendet e sistemit **evropian/kelsenian**.[294] Kjo nuk duket të jetë kështu në vendet

nuk do të duhej të ekspozoheshin ndaj sulmeve politike të cilat nuk janë në pajtim me neutralitetin e kërkuar nga gjyqësori në mënyrë që ta ruajnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor. Për këtë arsye, gjyqtarët do të duhej të përmbaheshin nga çfarëdo aktiviteti politik që mund të cenojë pavarësinë e tyre apo që e rrezikon përshtypjen e paanshmërisë së tyre (Shih *Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian (KKGJE) Opinioni nr. 3 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian për dijeni të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në lidhje me parimet dhe rregullat që rregullojnë sjelljen profesionale të gjyqtarëve, e në veçanti me etikën, sjelljen e papajtueshme dhe paanshmërinë, Strasburg, 19 nëntor 2002).*[…]".

293 Në vetë biografinë e ish-gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, **Kadri Kryeziu**, thuhet se ka qenë funksionar i lartë i dy partive politike: nga viti 1991-200, anëtarë i kryesisë së PPK ("Partia Parlamentare e Kosovës") kurse nga viti 200-2009, anëtar i kryesisë së **AAK** ("Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës"). Në internet: http://gjk-ks.org/judges/prof-dr-ass-kadri-kryeziu/ (shikuar në 2022).Ngjashëm është edhe rasti me gjyqtaren aktuale, **Selvete Gërxhaliu**, e cila ka qenë kandidate për deputete e **LDK**-së ("Lidhja Demokratike e Kosovës").Cf. KMDLNJ: Presidente, mos e dekreto Selvete Gërxhaliu – Krasniqin. **ZERI** 03 dhjetor 2015. Në internet: http://zeri.info/aktuale/65353/kmdlnj-presidente-mos-e-dekreto-selvete-gerxhaliu-krasniqin/ (shikuar në 2022).

294 Konrad Lachmayer, "The Austrian Constitutional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 85-86 (ku autori spjegon se në **Austri** janë kufizimet e njëjta sikur në rastin e **Kosovës**, mirëpo tregon se të qenit anëtar i një partie politike nuk përbën një pengesë për të qenë gjqytar aktiv, gjë që është situatë pak interesante); Zdeněk Kühn, "The Constitutional Court of the Czech Republic". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 199-236 në fq. 208-210 (ku autori shpjegon se ish-politikanë në Çeki janë nominuar në Gjykatë Kushtetuese, si pasojë e faktit se ekziston një sistem amerikan i nominimit ku presidenti emëron gjyqtarët me aprovimin e Senatit); Arthur Dyevre, "The French Constitutional Council", fq. 329 (ku autori tregon për ndarjen e anëtarve të **KKFr** në anëtarë dhe gjyqtarë: të parët janë zakonisht ish deputetë apo ministra qeveritar); Michaela Hailbronner and Stefan Martini, "The German Constitutional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* fq. 365 (ku autori tregon se kanë qenë shumë të rralla rastet e emërimit për gjyqtarë kushtetues në Gjermani të ish-politikanëve; autori përmend si rast të fundit ish kryeministrin e land-it të **Saar**); András Jakab and Johanna Frölich, "The Constitutional Court of Hungary". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 405 (ku autori tregon se zgjedhja e anëtarve të **Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë** ka qenë çdo herë një proces shumë i politizuar, por jo vetë anëtarët e saj: ata profesor universitar që kanë qenë të njërës anë politike, nuk janë zgjedhur sepse çdo herë është kërkuar konsensusi i opozitës dhe pozitës për shkak të shumicës së lartë të kualifikuar që kërkohet për zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetuese në **Hungari)**; Tania Groppi and Irene Spingo, "The Constitutional Court of Italy". Në

tjera që nuk i takojnë këtij sistemi.[295] Në rastin e **Kosovës** gjendja paraqitet si më e ndërmjetme dhe nuk mund të shpjegohet vetëm me praktikat dhe zgjedhjet kushtetuese të njërit prej dy grupimeve të vendeve si më sipër. Kjo shpjegon arsyen pse angazhimi politik dhe angazhimi tjetër publik përmendet menjëherë në fillim të paragrafit të parë të nenit 5 të **Ligjit nr. 03/L-121** që diskuton papajtueshmërinë. Ky paragraf p**ërmend** punët dhe angazhimet që një gjyqtar nuk mund t'i kryejë dhe postet që nuk mund t'i mbajë.[296] Këto ndalesa vlejnë edhe për anëtarët që janë kandidatë për gjyqtarë kushtetues. Kjo nënkupton se asnjë nga këto angazhime dhe aktivitete nuk guxon të ushtrohet apo të kryhet nga kandidatët që synojnë të jenë gjyqtar kushtetues. Ky aspekt i papajtueshmërisë ashpërsohet edhe më shumë kur bëhet fjalë për gjyqtarët kushtetues aktivë: ajo/ai nuk guxon asnjëherë të ushtrojë apo të kryejë punë dhe akti-

András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 525(ku autori thekson se gjyqtarët e **Gjykatës Kushtetuese të Italisë** janë njerëz me ekspertizë të lartë në lëmin e drejtësisë dhe me shumë pak përvojë politike apo fare të papërvojë në politikë); Marian Ahumada Ruiz, "The Spanish Constitutional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 617 (ku autori tregon se sistemi i papajtueshmërive pengon anëtarësimin në **GJKSp** të njerëzve me angazhim aktiv në politikë, mirëpo në të kaluarën ka pasur raste kur ish-politikanët janë zgjedhur gjyqtar kushtetues).

295 Në vendet që nuk i takojnë modelit **kelsenian/evropian**, kjo nuk përbën ndonjë problem të veçantë: ish-funksionarë politik apo njerëz që kanë shërbyer në poste politike caktohen gjyqtar të gjykatave të larta që ushtrojnë funksionet e gjykatës kushtetuese: për rastin e **Australisë**, cf. Cheryl Saunders and Adrienne Stoner, "The Hight Court of Australia". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning* fq. 39-40 (ku autori tregon se që nga viti 1975 janë caktuar 13 gjyqtar me prejardhje politike); për rastin e **Brazilit**, cf. Conrado Hubner Mendes, "The Supreme Federal Tribunal of Brasil". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 128-131 (ku autori sqaron se gjyqtarët e **Tribunalit Federal të Brazilit** mund të jenë një përzierje e atyre që kanë origjinë të fuqishme politike me profesionet tjera si avokat apo prokurorë publik); për rastin e **Britanisë së Madhe**, cf. Tamas Gyorfi, "The Supreme Court (House of Lords) of the United Kingdom". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 690-691 (ku autori shpjegon se politizimi i gjyqësisë së lartë në këtë vend ka pasur një traditë para Luftës së Dytë Botërore, kurse pas kësaj kohe ka nisur një procedurë e depolitizimit të saj); për rastin e **Kanadasë**, cf. Hugo Cyr and Monica Popescu, "The Supreme Court of Canada ". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 167-169 (ku autori tregon që kryeministri dhe ministri i drejtësisë caktojnë gjyqtarët e **Gjykatës Supreme të Kanadës**, kurse zgjedhja e politikanëve të dikurshëm ka përbë një praktikë të përhapur në vitit '50 të shekullit të kaluar, kurse dekadave të fundit kjo praktikë i ka lëshuar rrugë profesionalizmit dhe juristëve të karrierës gjyqësore si dhe akademikëve); për rastin e **Irlandës**, cf. Eoin Carolan, "The Supreme Court of Irland". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 446 (ku autori shpjegon se gjyqtarët caktohen nga qeveria dhe kjo përbën një bazë që në publik të ekzistoj perceptimi i politizimit të gjyqtarëve; pikërisht për këtë arsye, në këtë vend ka nisur iniciativa për ndryshim të këtij sistemi të caktimit të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, e cila kryen funksione të gjyqësisë kushtetuese në të njëjtën kohë); për **Izraelin**, cf. Suzie Navot, "The Israeli Supreme Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 478-480 (ku autorja shpjegon se në këtë vend ekziston një Komitet për Caktimin e Gjyqtarëve, i cili me një shumicë votash i zgjedh gjyqtarët e këtij vendi, përfshirë ata të Gjykatës Supreme; ky organ përbëhet nga nëntë vetë dhe pesë nga ata duhet të vijnë nga organet jopolitike, kryesisht nga gjyqësori dhe komuniteti legal; kjo gjykatë kryen funksione kushtetuese dhe çdo herë ka qëndruar larg politikës); për rastin e **SHBA**-ve, cf. në Howard Schweber and Jennifer L. Brookhart, "The Supreme Court of the United States". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 730-732 (ku autori shpjegon faktin që kushtetuta nuk kërkon përgatitjen prej juristi për të qenë gjyqtar i Gjykatës Supreme, mirë në praktikë kjo është si një rregull e pashkruar; nga gjysmën e dytë të shekullit XX, thekson autori, ka pasur një tendencë të fuqishme për rritjen e ndikimeve ideologjike të senatorëve amerikan me rastin e caktimit të gjyqtarëve të kësaj gjykate); për **Taivanin**, cf. Wen – Chen Chang, "The Constitutional Court of Taiwan". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 647-648 (ku autori shpjegon se nuk ka politikan në radhët e gjyqtarëve, por vetëm përfaqësues të komunitetit të gjyqësorit të rregullt ose profesor universiteti).

296 Në **Austri**, gjyqtari kushtetues nuk mund të jetë anëtar në organizmat politik dhe jo politik. Megjithatë. gjyqtari ka të drejtë që të japë këshilla me pagesë për çështjet kushtetuese që janë në zhvillim e sipër në GJKAust. Nga vitit 2015, në **Austri** është futur rregulli që gjyqtarët duhet t'i bëjnë publike anëtarësimet e tyre në pozita menaxhuese dhe nëpër borde të ndryshme kurse ende nuk ka ndalesa për konflikt interesi në dhënien e këshillave juridike kompanive private. Kjo do të thotë se në sferën private ende nuk ka nevojë të bëhet transparente pozitat në ekonomi private apo lidhur me dhënien e ndonjë këshille kompanive private. Cf. Konrad Lachmayer, "The Austrian Constitutional Court" Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 87.

vitete nga paragrafi i parë i nenit 5 si më sipër **Ligjit nr. 03/L-121**, përkatësisht nuk mund të jetë anëtar i një partie, lëvizje ose çfarëdo organizate tjetër politike, anëtar i bordit drejtues të një ndërmarrje publike, shoqërie tregtare ose organizate jo qeveritare dhe, në fund, nuk guxon të jetë anëtar i një sindikate. E thënë me fjalë të tjera, ajo/ai nuk guxon të marrë pjesë nëpër aktivitete të asnjërit prej organizmave politik, menaxheriale dhe sindikale.[297] Në paragrafin e dytë të nenit të njëjtë përcaktohen ndalesat tjera që formojnë papajtueshmëri absolute: gjyqtari i **GJKRKS** nuk mund të mbaj asnjë post tjetër publik apo profesional për të cilën shpërblehet me pagesë, përveç ushtrimit të funksionit të ligjëruesit të shkencave juridike në një universitet të akreditуar. Kjo nënkupton se puna si gjyqtar është marrëdhënie me orar të plotë e punë primare dhe, për pasojë, çdo punë në universitet mund të jetë vetëm dytësore. E theksojmë këtë sepse ka vende kur puna në gjykatë nuk është punë primare, por punë shtesë që mund të ushtrohet krahas një profesioni tjetër që ka natyrë primare (cilido qoftë ai profesion).[298] Kjo nuk është kështu në Kosovë. Në fjalinë e fundit të paragrafit të dytë, si më sipër, përcaktohet se çka konsiderohet post publik apo profesional: nuk konsiderohet post publik apo profesional nëse gjyqtari pa pagesë merret me veprimtari shkencore, apo pa pagesë angazhohet si anëtar në institute ose shoqata të juristëve, në organizata humanitare, kulturore, sportive dhe organizata tjera, përderisa këto aktivitete nuk kanë lidhje me punën e ndonjë partie politike. Kjo dispozitë është futur duke e pasur parasysh se në Kosovë ka pak kuadro universitare dhe shkencore, ashtu që, nëse do të futej si konflikt interesi një kategori e tillë e kuadrove, atëherë do të dobësohej niveli profesional i **GJKRKS.**

Rastet kur njëri prej gjyqtarëve të **GJKRKS** është duke ushtruar ndonjë post tjetër publik ose profesional për të cilën shpërblehet me pagesë pas marrjes së detyrës së gjyqtarit, duhet të merren vesh përmes vetëdeklarimit të saj/tij: gjyqtari menjëherë, pa shtyrje, duhet ta informojë kryetarin e GJKRKS për një gjë të tillë. Kryetari, ndërkaq, ka të drejtë të vendosë për të ndaluar ushtrimin e një posti apo funksioni të tillë. Nëse gjyqtari mendon se kryetari ka qenë i anshëm dhe nuk ka vlerësuar si duhet aktivitetin e tij jashtëgjyqësor që e ushtron, atëherë shumica e gjyqtarëve marrin vendim përfundimtar rreth asaj se kush ka të drejtë. Kjo parashikohet në paragrafin e katërt dhe të fundit të nenit 5 të **Ligjit nr. 03/L-121**, i cili në të njëjtën kohë është i heshtur rreth asaj nëse dikush tjetër, përveç gjyqtarit që ka konflikt të supozuar të interesit, mund të ngre çështjen e prezencës së rrethanës nga ky paragraf si më sipër. Nëse vërtetohet që ekziston papajtueshmëri dhe gjyqtari e ka fshehur një rrethanë të tillë, atëherë ajo/ai do të gjendet jo vetëm në shkelje të **Kodit të Etikës,**[299] por edhe të shkeljes së rëndë të detyrave të saj/tij si gjyqtar kushtetues.[300] Një rrethanë e tillë, e konstatuar nga **GJKRKS** në përbërje të plotë, përbën arsye të mjaftueshme për të propozuar shkarkimin e gjyqtarit të tillë kushtetues në

---

297 Në përvojën e **GJKRKS,** për fat të keq, është regjistruar vetëm një rast i tillë, kur një gjyqtar kushtetues, gjyqtari **Kadri Kryeziu**, pat marrë pjesë aktive në fushatën zgjedhore të njërës prej partive politike kosovare, **PDK** (**Partia Demokratike e Kosovës**), gjatë zgjedhjeve të përgjithshme të qershorit 2014. Në një mbledhje administrative, Gjykata ka trajtuar raportin e komisionit të caktuar nga kryetari i saj, prof.dr. **Enver Hasani**, me qëllim të konstatimit të përgjegjësisë. Komisioni pat gjetur se një sjellje e tillë e gjyqtarit në fjalë përbën një shkelje të detyrave të punës dhe është e papajtueshme me funksionin e gjyqtarit kushtetues. Pas shumë dilemave nëse gjytari **Kadri Kryeziu** duhej të shkarkohej, më në fund **GJKRKS** ka vendosur për një masë më të butë – masën e qortimit. Cf. funotat nr. 291,292,293 **supra**, në këtë pjesë, si dhe komentet tona lidhur me këtë.

298 Kështu është në **Austri**, një traditë që ka ngelë nga koha kur **Gjykata Kushtetuese** nuk ka pasur shumë punë. Kjo vlen vetëm për gjyqtarët, jo edhe për kryetarin dhe zëvendës kryetarin e saj: këta duhet të jenë në marrëdhënie të plotë pune në Gjykatë. Nuk ka rëndësi këtu nëse flitet për profesorë universitarë apo për avokatë apo ndonjë profesion tjetër: gjyqtarët kushtetues në këtë vend mund të ushtrojnë në të njëjtën kohë edhe profesionin e avokatit, noterit, profesorit universitar apo tjetër profesion të ngjashëm me këto. Cf. Konrad Lachmayer, "The Austrian Constitutional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), *Comparative Constitutional Reasoning*, fq. 86-87.

299 **GJKRKS** ka miratuar një kodin të mirësjelljes për gjyqtarë më 19 qershor 2013. Në internet: http://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2017/11/gjkkkodiimiresjelljespergjyqtareshq.pdf (shikuar në janar 2023).

300 Neni 10 ["Detyrat e gjyqtarëve"] i **Ligjit nr. 03/L-121**:
"1. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese kanë për detyrë të ushtrojnë me ndërgjegje dhe në mënyrë të paanshme funksionin e gjyqtarit dhe të vendosin sipas bindjes së lirë në pajtim me Kushtetutën.
2. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese kanë për detyrë të ruajnë reputacionin dhe dinjitetin e Gjykatës Kushtetuese.
3. Secili gjyqtar ka për detyrë të marrë pjesë në punën dhe procesin e vendimmarrjes së Gjykatës, si dhe të kryejë punët tjera të caktuara me ligj dhe me rregulloren e punës".

kuptim të nenit 118 të **KKos**.[301] lidhur me nenin 9.1 (5) të **Ligjit nr. 03/L-121.**[302] Kjo bazë për përfundim të mandatit para kohe, si dhe procedura për vënien në jetë të saj, specifikohen më tutje në një mënyrë të detajuar në rregullin 6 të **RrP**.[303]

Para caktimit si gjyqtar, përkatësisht para dhënies së betimit para **Presidentit të Republikës** dhe marrjes së dekretit për emërim, kandidati i zgjedhur nga Kuvendi duhet të japë dorëheqje nga postet (funksionet) e përcaktuara nga dy paragrafët e parë të nenit 5 të **Ligjit nr. 03/L-121.** Kështu thuhet në paragrafin e tretë të këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet **Presidentit të Republikës.**

27.5. Imunitetet dhe shkarkimi

Ka shtete që nuk parashohin (ofrojnë) imunitet penal për gjyqtarët kushtetues, përkatësisht fare nuk kanë dispozita kushtetuese apo ligjore që rregullojnë imunitetet e gjyqtarëve kushtetues (apo gjyqtarëve të gjykatave të larta që kryejnë funksione kushtetuese).[304] Në skajin tjetër, as nuk janë të pakta shtetet që u njohin gjyqtarëve kushtetues kategorinë e **imunitetit të përgjithshëm/ absolut (non-violability)**.[305] Në këto shtete, një gjyqtar kushtetues konsiderohet penalisht përgjegjës: gjatë ushtrimit të mandatit,

---

301 Neni 118 ["Shkarkimi "] i **KKos**: "Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese mund të shkarkohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës me propozimin e dy të tretave (2/3) të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, vetëm për kryerjen e krimeve të rënda ose **për mospërfillje të rëndë të detyrave"**.

302 Neni 9. 1.5 ["Përfundimi i mandatit para kohës"] **Ligjit nr. 03/L-121:**
"1. Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese i pushon mandati para skadimit të kohës së rregullt për të cilën është zgjedhur në rast të:
1.1. dorëheqjes;
1.2. vdekjes;
1.3. humbjes së përhershme të aftësisë së veprimit të konstatuar nga gjykata kompetente;
1.4. sëmundjes apo problemeve të tjera shëndetësore, të cilat e bëjnë të pamundur ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese;
1.5. shkarkimit sipas nenit 118 të Kushtetutës".

303 Rregulli 6 ["Procedurat për shkarkim"] i **RP** (miratuar më 23 nëntor 2001):
"1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të shkarkohet vetëm në këto raste:
a. në rast të kryerjes së ndonjë krimi të rëndë, **në rast të mospërfilljes së rëndë të detyrave të punës**,
b. në rast të humbjes së përhershme të aftësisë për të vepruar, ose
c. në rast të sëmundjes a të ndonjë problemi tjetër shëndetësor, që e bën të pamundur ushtrimin e përgjegjësive dhe të funksionit të gjyqtarit.
2. Shkarkimi mund të propozohet nëpërmjet një dokumenti të shkruar, ku përshkruhet baza për shkarkim, dhe i cili nënshkruhet nga një ose më shumë gjyqtarë dhe i dorëzohet Kryetarit. Dokumentet që përmbajnë çfarëdo fakti të rëndësishëm, duhet t'i bashkëngjiten propozimit për shkarkim. Propozimi për shkarkim duhet të jetë konfidencial dhe të gjithë gjyqtarët duhet të njoftohen me të sa më shpejt që të jetë e mundur.
3. Kryetari njofton me shkrim gjyqtarin e propozuar për shkarkim mbi bazën e propozimit për shkarkim dhe i jep gjyqtarit përkatës propozimin e shkruar dhe të gjitha faktet relevante të bashkëngjitura. Në rast se Kryetari propozohet për shkarkim, Zëvendëskryetari i bën njoftimin e njëjtë Kryetarit.
4. Gjyqtarët mbajnë takim konfidencial, për të diskutuar shkarkimin e propozuar. Gjyqtari i propozuar për shkarkim ka të drejtë të jetë i pranishëm në takimin konfidencial dhe ka të drejtë të përgjigjet ndaj propozimit për shkarkim, të japë ose të paraqesë shpjegime ose informacione dhe t'u përgjigjet pyetjeve të gjyqtarëve.
5. Gjyqtarët mbajnë një takim tjetër konfidencial nga i cili përjashtohet gjyqtari i propozuar për shkarkim. Në këtë takim, gjyqtarët përcaktojnë nëse do t'ia propozojnë këtë shkarkim Presidentit të Republikës së Kosovës. Kryetari i Gjykatës e kryeson këtë takim dhe diskutimet e gjyqtarëve mbesin konfidenciale. Për t'i propozuar shkarkimin Presidentit të Republikës së Kosovës, propozimi për shkarkim duhet të votohet nga 2/3 e të gjithë gjyqtarëve të mbetur të Gjykatës. Gjyqtarët duhet të kenë të drejtë, po ashtu nëpërmjet shumicës prej 2/3, të vendosin sanksione ose masa disiplinore që janë më pak të ashpra sesa shkarkimi, në rast se rrethanat e lejojnë një gjë të tillë".

304 Në këtë grup të shteteve hyjnë, ta zëmë, vendet si Austria, Belgjika, Gjermania, Finlanda, Franca, Irlanda, Japonia, Lihtenshtajni, Kanada, Malta, Norvegjia, Suedia dhe Zvicra. Cf. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *The Composition of Constitutional Courts,* fq. 18.

305 Në literaturë është vërejtur se në Evropë nga 47 vendet anëtare të KE-së në vitin 2011, 20 syresh e njohin këtë lloj të imunitetit për gjyqtarët e gjykatave të larta, përfshirë gjyqtarët kushtetues. Cf. Tilman Hoppe, "Public Corruption: Limiting Criminal Immunity of Legislative, Executive and Judicial Officials in Europe" *Vienna Journal of International Constitutional Law* Vol. 5 No. 4 (2001) fq. 538-549, në fq. 539-540.

megjithatë, ajo/ai nuk mund të arrestohet, ndiqet penalisht apo të dërgohet nëpër procedura gjyqësore penale, civile apo administrative. Nuk ka rëndësi nëse vepra është kryer gjatë apo para fillimit të mandatit si gjyqtar kushtetues. Këtu, me një fjalë, nuk ka rëndësi natyra e veprës, përfshirë këtu veprat që fare nuk kanë të bëjnë me ushtrimin e funksionit gjyqësor. Çdo gjë pezullohet. Asgjë nuk mund të lëvizë përpara gjatë tërë kësaj kohe sa zgjat mandati.[306]

Në **Kosovë** ekziston një zgjidhje më e nuancuar: si në shumicën e vendeve të demokracive kushtetuese të proveniencës liberale perëndimore, **KKos** në nenin e saj 117 flet për imunitetin, në një paragraf të vetëm. Aty thuhet se "Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga detyra për vendimet e marra, mendimet e shprehura dhe veprimet e marra brenda fushës së përgjegjësive si gjykatës të Gjykatës Kushtetuese". Nga redaktimi i këtij neni del qartë se gjyqtarët kushtetues janë të veshur me imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga detyra për sa i përket kryerjes së funksionit të tyre, mendimeve të shprehura, dhe në tërësi veprimeve të ndërmarra në kapacitetin e tyre si gjyqtarë kushtetues. Këtu bëhet fjalë për **imunitet funksional** të gjyqtarëve kushtetues, i emërtuar nganjëherë edhe si **imunitet nga përgjegjësia** (**non-liablity**). Me këtë nënkuptohet se gjyqtarët kushtetues nuk janë të imunizuar nga veprimet e ndërmarra jashtë funksionit të tyre si gjyqtarë kushtetues. Në këtë kontekst, **GJKRKS** në rastin **KO 98/11** ka pasur rast që të interpretojë dispozitën kushtetuese lidhur me imunitetin, duke saktësuar natyrën juridiko-kushtetuese dhe parametrat vlerësues të imunitetit funksional të funksionarëve të lartë shtetëror në **Kosovë**.

Kategoritë e mësipërme të imunitetit, zakonisht përcaktohen me kushtetutë nacionale. Të rralla janë rastet kur imuniteti caktohet me ligj të zakonshëm. Ky standard preferohet më shumë nga shkaku se ligjvënësit jo rrallë kanë prirje për të zgjeruar rrethin e personave me imunitet, në veçanti të atyre me **imunitet të përgjithshëm/absolut**, gjë që përbën një pengesë serioze për luftimin e korrupsionit.[307] U mor vesh, jo rrallë, kushtetutat (dhe ligjet) sanksionojnë dy llojet e imunitetit, duke e specifikuar procedurën dhe mekanizmin e heqjes vetëm sa i përket kategorisë së **imunitetit të përgjithshëm/absolut.**

Kategoria e **imunitetit funksional** të gjyqtarëve në përgjithësi, përfshirë edhe gjyqtarët kushtetues, siç do të përshkruhet në vijim, përbën një standard të përkrahur fuqishëm nga **Komisioni i Venecias.**[308] Si i

---

306 Ky lloj imuniteti njihet si **imuniteti i paprekshmërisë** (**non-violability**) dhe është më i vjetri dhe më i përhapuri në **Evropë**: në shumicën e shteteve evropiane ky lloj imuniteti njihet për parlamentarët, kurse më pak për gjyqtarët dhe oficerët e larët të ekzekutivit të vendit. Kjo vlen për vendet e demokracive tradicionale evropiane, me përjashtim të **Italisë**. Në disa vende ish-komuniste të **Evropë,** ky imunitet shtrihet edhe ndaj gjyqësorit, përfshirë gjykatat kushtetuese. Ibid. fq. 539-540.

307 Cf. Tilman Hoppe, "Public Corruption: Limiting Criminal Immunity of Legislative, Executive and Judicial Officials in Europe" *Vienna Journal of International Constitutional Law* Vol. 5 No. 4 (2001), fq. 545.

308 "[…] 19. Si përfundim, gjyqtarët duhet të gëzojnë vetëm imunitet funksional, përkatësisht imunitet nga ndjekja penale vetëm për aktet e ligjshme të ndërmarra gjatë kryerjes së funksioneve të tyre. Në këtë kuptim, duhet qartë që korrupsioni pasiv, ushtrimi i ndikimit, mitmarrja dhe veprat e ngjashme nuk mund të konsiderohen akte të kryera gjatë ushtrimit të ligjshëm të funksioneve gjyqësore […]". European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Amicus Curiae Brief on the Immunity of Judges for the Constitutional Court of Moldova*. Adopted by the Venice Commission at Its 94th Plenary Session (Venice, 8-9 March 2013). **689/2012. CDL – AD (2013) 008.** Original: English. Opinion Strasbourg, 11 March 2013. Në internet: https:// www.venice.coe.int/webforms / documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2013)008-e (shikuar në janar 2023). Pikëpamje të ngjashme, **Komisioni Venecias** ka shprehur edhe në rastet tjera të ngjashme: European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Memorandum Reform of the Judicial System in Bulgaria. Conclusions* adopted by the Venice Commission at its 55th plenary session (Venice, 13-14 June 2003). **Opinion N° 246/2003**. **Strasbourg**, 20 June 2003. CDL-AD (2003)12 Or. Engl. Në internet: http://www. venice coe.int/ webforms/documents/default. aspx?pdffile=CDL-AD(2003)012-e (shikuar në janar 2023). (në paragrafin nr. 15 nën "a", Memorandumi konstaton se gjyqtarët, përfshirë gjyqtarët kushtetues nuk duhet të gëzojnë imunitet të përgjithshëm/absolut por vetëm funksional dhe duhet të jenë përgjegjës për veprat e kryera penale si çdo qytetar tjetër,m kurse nuk duhet të jenë përgjegjës civil për dëmet e shkaktuara gjatë ushtrimit të funksionit të tyre me mirëbesim dhe ndershmëri; memorandumi po ashtu konstaton se nuk mund të bëhet dallim në mes të imunitetit të parlamentarëve dhe gjyqtarëve, përfshirë gjyqtarët kushtetues kurse për heqjen

tillë, ai është sanksionuar me një marrëveshje shumëpalëshe ndërkombëtare të **Këshillit të Evropës** qysh në vitet e para formative të **GJEDNJ-së**. Kjo marrëveshje e bën të qartë se imuniteti nuk është dhe nuk guxon të jetë qëllim në vete: ai i shërben pavarësisë së gjyqtarit në mënyrë që ajo/ai mos të ketë frikë se do të përndiqet nëpër procedura gjyqësore për detyrat që i ka ushtruar me mirëbesim dhe ndershmërisht në kohën sa ka qenë gjyqtar.[309] Këtë orientim e ka përqafuar në mënyrë të qartë dhe shprehimore **KKos** në nenin e sipërcituar 117: pjesa e fundit e fjalisë e identifikon në mënyrë të qartë kategorinë e **imunitetit funksional** kur saktëson se me imunitet mbulohen vetëm vendimet, mendimet dhe veprimet e ndërmarra brenda fushës së përgjegjësive si gjykatës kushtetues. Kjo është arsyeja pse as **KKos** dhe as **Ligji Nr. 03/L-121** nuk përcaktojnë mekanizmin për heqjen e tij.

Kosova nuk ua njeh gjyqtarëve kategorinë e **imunitetit të përgjithshëm/absolut**, siç u pa nga redaktimi i nenit 117 të **KKos**. Vetëm me **imunitet funksional** janë të veshur gjyqtarët kushtetues kosovarë. Ky imunitet është relativ për faktin se vlen dhe mbulon ekskluzivisht vetëm sferën që ka të bëjë me procesin e vendimmarrjes së gjyqtarit kushtetues. Kjo nënkupton se për çështjet tjera, ajo/ai në tërësi i nënshtrohet legjislacionit penal, civil dhe administrativ si çdo qytetar tjetër i **Kosovës**. Kjo përbën, në fakt, vetë thelbin e qëllimit të cilit i shërben **imuniteti funksional**: ai qëllim ka të bëjë pikërisht me garantimin e barazisë para ligjit për të gjithë. Këtë kategori të imunitetit e ka mbrojtur fuqishëm **GJKRKS** në një interpretim të cilin e ka marrë lidhur me caqet dhe llojin e imuniteteve të funksionarëve shtetëror në **Kosovë**. Fjalën e kemi për interpretimin e dhënë në rastin e sipërpërmendur **KO 98/11**, ani që nuk ka pasur të bëjë në mënyrë shprehimore me gjyqtarët kushtetues. Ai rast ka pasur të bëjë në mënyrë shprehimore me presidentin, kryeministrin dhe anëtarët e qeverisë dhe me deputetët e Kuvendit të Kosovës. Kjo fare nuk ka

e imunitetit konstaton se kërkesa për këtë nuk duhet të vij vetëm nga prokurori i përgjithshëm); European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Report on the Independence of the Judicial System. Part I: The Independence of Judges,* (në paragrafin nr. 61 të këtij studimi theksohet pakontestueshmëria e imunitetit funksional të cilin duhet ta gëzojnë gjqytarët, përkatësisht imunitetin për aktivitetet e ushtruara gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare; përjashtim nga imuniteti në këtë paragraf, në mënyrë shprehimore, përbëjnë veprat penale të korrupsionit dhe krimit tjetër të kryer me qëllim); European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Opinion on the Draft Law on Judges and Prosecutor of Turkey*. Adopted by the Venice Commission at its 86th Plenary Session (Venice, 25-26 March 2011). **Opinion No. 610 / 2011**. **Strasbourg**, 29 March 2011. CDL-AD(2011)004 Or. Engl. Në internet: http://www.europarl.europa.eu/meetdocs/2009 _2014/ documents/d-tr/ dv/ 112817/ 112817 en.pdf (shikuar në janar 2023) (ky mendim në pargrafin nr. 88 përsërit qëndrimin e mëhershëm të Komisionit për imunitet funksional); European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Opinion on Act CLI of 2011 on the Constitutional Court of Hungary.* Adopted by the Venice Commission at its 91st Plenary Session (Venice, 15-16 June 2012). **Opinion no. 665 / 2012. Strasbourg**, 19 June 2012. CDL-AD(2012)009 Or. Engl. Në internet: http://www.venice.coe.int/webforms/ documents/default.aspx? pdffile=CDL-AD(2012)009-e (shikuar në janar 2023) (në paragrafin nr. 14 të Mendimit thuhet se imuniteti funksional ngelet prioritet i Komisionit dhe përbën një standard evropian; sa i përket përgjegjësisë civile, Komisioni i rekomandon **Hungarisë** standard evropian: që të mbajë përgjegjës gjqytarët vetëm në ato raste kur dëmi është shkaktuar me qëllim të keq dhe si pasojë e ushtrimit të pandërgjegjshëm të detyrës); European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Opinion on Proposals Amending the Drfat Law on the Amendments to the Constitution to Strengthen the Independence of Judges of Ukraine.* Adopted by the Venice Commission at its 97th Plenary Session (Venice, 6-7 December 2013). **Opinion no. 747 / 2013**. **Strasbourg,** 10 December 2013. CDL-AD(2013)034 Or.Engl. Në internet: http://www.venice.coe.int/webforms /documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2013)034-e (shikuar në janar 2023) (mendimi kritikon imunitetin e fuqishëm që u njihet gjyqtarëve dhe propozon ndryshiumin e kushtetutës meqë këto imunitetet të përgjithshme/absolute garantohen me kushtetutë e jo me ligjin që ka qenë objekt i këtijmendimi).

309 Neni 6 i **Protokollit të Katërt të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Këshillit të Evropës** e vitit 1961 përcakton si vijon: ”Privilegjet dhe imunitetet e dhëna gjyqtarëve nuk janë për përfitim të tyre personal por me qëllim që të sigurohet ushtrimi i pavarur i funksioneve të tyre. Askush nuk është kompetent përveç Gjykatës, në një mbledhje plenare, për të vendosur për të hequr imunitetin e gjyqtarëve; ajo jo vetëm që ka të drejtë, por edhe detyrë për të hequr imunitetin e një gjyqtari në rastet kur, sipas mendimit të saj, imuniteti mund të pengoj kursin e drejtësisë me kusht që kjo heqje mund të bëhet pa paragjykuar qëllimin për të cilin imuniteti është dhënë“. **Fourth Protocol to the General Agreement on Privileges and Immunities of the Council of Europe**. Paris, 16. XII. 1961. European Treaty Series - No. 36. Në internet: https://rm.coe.int/CoERMPublic Common SearchServices/DisplayDCTMContent? documentId =090000 168006b643 (shikuar në janar 2023).

rëndësi sepse, interpretimi në fjalë, **mutatis mutandis**, vlen në tërësi edhe për vetë gjyqtarët e kushtetues. Kjo është kështu për dy arsye: e para, sepse dispozitat kushtetuese lidhur me imunitetin e funksionarëve të lartë shtetëror të **Kosovës** dhe deputetëve të Kuvendit janë në tërësi të njëjta, përfshirë këtu dispozitat për imunitetin e gjyqtarëve të gjyqësorit të rregullt dhe **Avokatit të Popullit;**[310] e dyta, sepse gjyqtarët kushtetues gëzojnë statusin protokollar të ministrave të qeverisë dhe barazohen me **kryetarin e GJSKos**, kurse vetë **kryetari i GJKK-së ose** gëzon rangun ceremonial dhe protokollar të kryeministrit dhe kryetarit të Kuvendit. Ky status i gjyqtarëve kushtetues është afërsisht kësisoj edhe në vendet tjera të modelit **evropian/kelsenian** të gjyqësisë kushtetuese.

Lidhur me **shkarkimin** e gjyqtarëve të **GJKRKS**, në **KKos** gjendet vetëm një nen, neni 118, në të cilin thuhet se "Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese mund të shkarkohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës me propozimin e dy të tretave (2/3) të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, vetëm për kryerjen e krimeve të rënda ose për mospërfillje të rëndë të detyrave". Sikundër shihet nga kjo dispozitë, ekzistojnë disa elemente që duhen marrë parasysh me rastin e shkarkimit të gjyqtarëve kushtetues, sepse bëhet fjalë për një organ shumë të rëndësishëm shtetëror, që ka për funksion primar mbrojtjen e epërsisë së KKos, letrës dhe frymës së saj. Në rend të parë, shkarkimi bëhet nga ana e Presidentit të Republikës, por vetëm pasi të ekzistoj një vendim paraprak i vetë anëtarëve të **GJKRKS**, i cili merret me dy të tretat e të gjithë anëtarëve. Kjo nënkupton se shefi shtetit nuk mund të inicioj vetë një gjë të tillë, dhe as të merr vendim autonom pa pasur vendimin e **GJKRKS**. Pragu prej dy të tretave ka peshë të madhe, sepse siguron anëtarët e këtij organi kushtetues se nuk mund të vjen deri te shkarkimi dosido, por duhet për të të vendosin një shumicë e kualifikuar e kolegëve. Ky prag, në të njëjtën kohë, nuk guxon të shikohet në mënyrë të izoluar: Përveç votimit në kuptimin teknik dhe mekanik, duhet të ekzistoj një sjellje e gjyqtarit kushtetues që formon figurën e veprës së rëndë penale ose përbën ndonjë sjellje të turpshme (të pahijshme) që cenon rënd moralin shoqëror (ta zëmë, pirja alkool pa kontroll dhe prishja e rendit dhe qetësisë, vizitimi vendeve që janë nën dinjitetin e gjyqtarit kushtetues, involvimi në punë që janë moralisht të papranueshme). Në ndërkohë që për veprën e rëndë penale gjendet lehtë parametri për vlerësim të sjelljes së gjyqtarit kushtetues, sepse atë e konfirmon gjykata kompetente me vendim të **formës së prerë**, pra nuk mjafton nisja e procedurave penale (hetimet, akuzat formale dhe gjykimi), për sjelljen e pahijshme në kuptimin më të gjerë të fjalës kërkohet vlerësim autonom i kolegëve të gjyqtarit kushtetues që është involvuar në sjellje të tillë të pahijshme.

---

[310] E kemi fjalën për dispozitat e **KKos** që kanë të bëjnë me deputetët e Kuvendit (neni 75.1), Presidentin e Kosovës (89), Kryeministrin dhe anëtarët e Qeverisë (neni 98), gjyqtarët e gjyqësorit të rregullt (neni 107.1) dhe Avokatin e Popullit (134.4). Pikërisht për këtë arsye janë tërësisht të paqëlluara dhe joprofesionale konstatimet që thonë se **GJKRKS** me vendimin e vet në rastin **KO 98/11** ka rishkruar normat kushtetuese mbi imunitetin e funksionarëve të lartë shtetëror të Kosovës. Cf. Dren Doli, Fisnik Korenica and Albana Rexha, *Promising Early Years: The Transformative Role of the Constitutional Court of Kosovo* (Analitika: Center for Social Research, Sarajevo, 2015) fq.62-64 (autorët, përveç kësaj, gabimisht mendojnë se rastin e ka ngritur **Kryeministri i Kosovës**, gjë që nuk është fare e vërtetë sepse Kryeministri nuk ka të drejtë të inicoj çështje kushtetuese); Cf. ngjashëm edhe te Andrea Lorenzo Capussela, "A Critique of Kosovo's Internationalized Constitutional Court", fq 27-29.Si në **Kosovë**, ashtu dhe gjetiu, gjykatat kushtetuese nuk bëjnë asgjë pos interpretojnë normat juridike duke shikuar nëse ato janë në harmoni me kushtetutën. Që nga **Hans Kelsen** e deri më sot kjo ka qenë cilësia themelore që ka dalluar gjyqësinë kushtetuese nga gjyqësia e rregullt. Si produkt i pashmangshëm i kësaj cilësie ka qenë tjetra cilësi, e njohur is **prezumimi i kushtetutshmërisë së normave juridike** që janë në fuqi. I parë në këtë kontekst, në rastin **KO 98/11**, **GJKRKS** vetëm ka konfirmuar, përmes riinterpretimit, se në **Kosovë** ekziston vetëm një lloj imuniteti, **imuniteti funksional** apo **imuniteti nga përgjegjësia** (**non-liability**), duke sqaruar dy gjëra: e para, se në Kosovë ka vetëm një lloj imuniteti, diçka që ende nuk është e qartë në Kosovë; dhe, dy, se arrestimet e funksionarëve të lartë shtetëror mund të ndodhin, njëjtë si në shumicën dërrmuese të vendeve të demokracive kushtetuese, për aktet dhe veprimet që nuk kanë të bëjnë me fushën e përgjegjësisë së tyre si deputet, anëtar i qeverisë dhe kryeministër dhe Avokat i Popullit.I vetmi përjashtim në këtë drejtim, sipas sqarimit të **GJKRKS** në rastin **KO 98/11**, ka të bëjë me presidentin: ajo/ai nuk mund të arrestohet në asnjë rrethanë gjatë kohës sa mban postin e shefit të shtetit. Këto standarde, siç do të shihet në vijim, janë të ngulitura thellë në punën dhe mendimet e **Komisionit të Venecias** dhe në vendet që përqafojnë demokracinë kushtetuese liberale. Thënë me fjalë tjera, në vijim do të shihet se **imuniteti funksional** dominon në pjesën dërrmuese të kushtetutave të vendeve të **Evropës** dhe përtej saj.

27.6. Kompetenca dhe vendimet

Në **Kosovë** kontrolli i ligjshmërisë nuk bëhet nga ana e **GJKRKS**, por vetëm nga ana e gjyqësorit të rregullt. Njëjtë si në vendet tjera të demokracive kushtetuese perëndimore, ku ekziston **modeli evropian/kelsenian**, në **Kosovë** kjo epërsi sigurohet përmes një organi tjetër të veçantë dhe me juridiksion të qartë kushtetues për një gjë të tillë. Sikundër u tha, monopoli për të thënë se çka është normë ligjore, nuk hyn në menynë e juridiksionit të gjyqësisë aktuale kushtetuese në Kosovë, siç është rasti në disa vende të tjera: dikur kontrolli i ligjshmërisë ka qenë prerogativë e **Gjykatës Kushtetuese të KSAK**, për shkak se ligjshmëria socialiste ka qenë emblemë e tërë sistemit kushtetues komunist ish-jugosllav.

Si një **pouvoir constitué**, gjyqësia kushtetuese paraqitet si një veprimtari shtetërore që kryen punë sipas autorizimit shprehimor kushtetues, me një dallim që bën kontrollin e kushtetutshmërisë së veprimeve dhe lëshimeve të të tjerëve. Për dallim nga organet tjera, mbi të cilat qëndron një autoritet përfundimtar për të treguar, siç thuhet ndër laikët, se çka është mirë e çka është keq sipas KKos, në rastin e GJKRKS kjo nuk është kështu: ajo nuk ka asnjë autoritet tjetër mbi vete përveç autoritetit të KKos: "Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësive të saj", thotë paragrafi i dytë i nenit 112 ["Gjykata Kushtetuese"] të kapitullit VIII të Kushtetutës, fjali që nuk është përdorur askund tjetër dhe për asnjë organ tjetër kushtetues.

Struktura e juridiksionit të saj bazik përcaktohet me dy nene të **KKos**, respektivisht nenet 4.6 dhe 112.1. Në dy rastet përmblidhet esenca e dizajnit kushtetues kosovar dhe roli themelor i gardianit kushtetutës – sigurimi i epërsisë së **KKos**. Kështu, neni 4 i kapitullit I ["Dispozitat Themelore"] të **KKos** flet për formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushtetit, kurse në paragrafin e 6-të të këtij neni flitet për formën e qeverisjes në Kosovë dhe mënyrën e ndarjes së pushtetit.[311] Këtu konstatohet se ajo është një organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe interpretuesi përfundimtar i **KKos**. Këtë interpretim e bën nëpërmjet ushtrimit të juridiksionit të saj të paraparë në nenin 113 të **KKos** ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"], si dhe të **juridiksionit shtesë** që mund të përcaktohet me ndonjë ligj të veçantë.[312]

---

311 Neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] i **KKos**:
"1. Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë;
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ;
3. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë;
4. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar;
5. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat;
6. Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës;
7. Republika e Kosovës ka institucionet e veta për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe të integritetit territorial, rendit dhe qetësisë publike, të cilat funksionojnë nën autoritetin kushtetues të institucioneve demokratike të Republikës së Kosovës".

312 Juridiksionin shtesë dikur parashihej për Gjykatën me nenin 106.1 ["Rezultatet Zgjedhore"] të **Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të 5 qershorit 2008; Në ndërkohë, me amendamentimet e këtij neni, të kryera me Ligjin 03/L-256 të datës 29 tetor 2010, ka ardhur deri te riformulimi i dispozitës së nenit 106.1 si më sipër, të cilat i njihnin Gjykatës Kushtetuese juridiksion shtesë në këtë fushë. Kështu, tani, ai nen thotë kështu**"[...] Neni 106.1 KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime dhe qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha ankesat që u përkasin votimit dhe numërimit të vendosura nga PZAP-i dhe çdo apel ndaj vendimeve të PZAP-it lidhur me to të jetë vendosur nga Gjykata Supreme e Kosovës". Cf. Ligji nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-073 për Zgjedhjet e Përkohshme ne Republikën e Kosovës. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* nr. 87, datë 16 nëntor 2010.Një rast tjetër ka të bëj me nenin 64.2.3 të **Ligjit Nr. 03/L-04 për Vetëqeverisjen Lokale, të 20 shkurtit 2008.** *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* nr. 28, datë 4 qershor 2008.

Fizionomia e **GJKRKS** nga neni 4 si më sipër, rikonfirmohet më tutje në nenin 112.1["Parimet e Përgjithshme"] të kapitullit VIII, të veçantë, që flet për te. Në këtë vend thuhet se "[...] Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën". Ky nen është definues i fizionomisë së saj dhe nuk ka implikacione konkrete për juridiksionin e saj, gjë që nënkupton se në mënyrë autonome nuk mund të shërbejë si bazë juridike për vendosje. Ajo gjendet aty më shumë si një vërejtje për të gjithë autoritetet tjera publike lidhur me rolin dhe pozitën e saj në sistemin e tërësishëm kushtetues, ashtu që askush të mos të ketë asnjë dyshim lidhur me rolin dhe pozitën e vet kushtetuese kundrejt **GJKRKS**. Cilësia e dytë që përcakton fizionominë e Gjykatës, ka të bëjë me **juridiksionin** e saj nga neni 113 i **KKos**. Ky juridiksion përcaktohet qartë me këtë nen. Kur thuhet se juridiksioni shtesë përcaktohet me ligj, siç bëhet në paragrafin e fundit të nenit 113, fjala është për një juridiksion që nuk mund të jetë veçse në përputhshmëri me dispozitat kushtetuese që rregullojnë fushën respektive që normohet me ligj si juridiksioni shtesë në kuptimin si më sipër (zgjedhjet e përgjithshme dhe vetëqeverisja lokale). Kjo cilësi e fizionomisë së **GJKRKS** ndryshe njihet si **gjyqësi kushtetuese juridiksionale**, që nënkupton se kushtetuta nacionale në mënyrë të qartë dhe pa asnjë dyshim përcakton sferën e të drejtave dhe detyrave të organit që ka monopol për interpretim kushtetues dhe për ushtrim të kontrollit të kushtetutshmërisë.

Siç mund të vërehet nga këto dy nene si më sipër, **KKos** nuk bën dallim në mes të interpretimit kushtetues (**constitutional interpretation**) dhe kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë (**judicial review**). Me **interpretim kushtetues** nënkuptohet procesi i ndërtimit apo krijimit të kuptimit dhe i sqarimit të kushtetutës nacionale (nëse ekziston si tekst i shkruar), i teksteve të tjera kushtetuese, i normave dhe parimeve të pashkruara që kanë veçori kushtetuese. Me **kontroll kushtetues** apo **kontroll gjyqësor të kushtetutshmërisë**, ndërkaq, nënkuptohet procesi në të cilin vlerësohet nëse sjellja e një akteri kushtetues është në pajtim me kushtetutën, me tekstet tjera juridike apo me parimet që kanë cilësi kushtetuese.[313] Ky i fundit, siç u pa më sipër, mund të ushtrohet nga një organ i ndarë dhe i veçantë me mandat të posaçëm për një gjë të tillë dhe me juridiksion të numëruar në tekstin kushtetues (gjykatat e ndara kushtetuese), ose edhe nga krejt sistemi gjyqësor i vendit në të gjitha nivelet, në kuadër të gjykimit dhe vendosjes për rastet dhe mosmarrëveshjet konkrete të natyrës së përgjithshme (gjykatat e rregullta të të gjitha niveleve ose vetëm gjykata më e lartë në vend). U mor vesh, si raste të ndërmjetme janë vendet që kultivojnë organe shtetërore me juridiksion të përzier (**hibrid**).

27.7. Juridiksioni i kufizuar (gjatë pavarësisë së mbikëqyrur dhe pas themelimit të Gjykatës Speciale)

Kufizimi i juridiksionit të **GJKRKS** që ka ndodhur gjatë kohës së pavarësisë së mbikëqyrur ka pasur të bëjë me kufizimet si pasojë e ekzistimit të dispozitave specifike të natyrës së përkohshme në të drejtën kushtetuese pozitive të Kosovës së asaj kohe. Kjo periudhë ka zgjatur deri në vitin 2012, vit në të cilin janë shfuqizuar dispozitat e **KKos** që i jepnin epërsi absolute dispozitave të **Planit Ahtisari**. Këto lloje të kufizimeve kanë qenë imanencë e faktit të thjeshtë se **KKos** është derivat i drejtpërdrejtë i Planit, jo anasjelltas. Për pasojë, epërsia e KKos nuk ka mundur të vijë në shprehje. Siç e kemi theksuar më sipër, normat kushtetuese dhe praktikat kushtetuese është dashur të jenë në harmoni me Planin.[314] Kjo gjë është reflektuar si në juridiksionin e **GJKRKS**, ashtu dhe në vetë përbërjen e saj.

313 Maartje de Visser*, Constitutional Review in Europe. A Comparative Analysis* (Hart Publishing: Oxford, 2013), fq. 2.

314 Kapitulli XIII [Dispozitat Përfundimtare] i **KKos**:Neni 143 [**Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës**]
"Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj Kushtetute:
1. Të gjitha autoritetet në Republikën e Kosovës veprojnë në pajtim me të gjitha detyrimet e Republikës së Kosovës sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007. Ato do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e tyre.
2. Dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007, kanë epërsi ndaj të gjitha dispozitave të tjera ligjore në Kosovë.

Kjo periudhë mund të cilësohet si periudha e supremacisë (epërsisë) së përkohshme e Planit. Në këtë kohë, kjo supremaci (epërsi) është siguruar nga organet vendore, në rend të parë nga **GJKRKS**, e cila ka pasur në gjirin e saj tre gjyqtarë ndërkombëtarë. Në fakt, ka qenë detyrim kushtetues i saj për të siguruar këtë epërsi. Nëse ajo nuk do ta bënte një gjë të tillë, interpretimi i saj përfundimtar bëhej nga autoritetet ndërkombëtare të caktuara sipas Planit.[315] Kjo nënkupton se interpretimi i planit dhe kontrolli i kushtetutshmërisë bëheshin në harmoni më dispozitat e këtij dokumenti ndërkombëtar.

27.8. Juridiksioni aktual i Gjykatës Kushtetuese

GJKRKS ka juridiksionin më të gjerë të mundshëm, krahasuar me gjykatat simotra në **Ballkan.** Ai është shumë i afërt me sistemin gjerman të gjyqësisë kushtetuese. Kjo do të thotë, me një fjalë, se ajo ka juridiksion mbi të gjitha veprimet e të gjitha autoriteteve publike në vend, përfshirë këtu gjyqësorin. Shumë pak çështje kanë ngelur jashtë juridiksionit të saj, ta zëmë, procedurat sipas **actio popularis**, mekanizmi i kontrollit kushtetues të partive politike, procedurat penale kundër funksionarëve të lartë shtetëror etj. Edhe në rastin tonë, sikundër çdo kund tjetër në botë, juridiksioni kushtetues reflekton historikun e nevojave dhe qëllimeve konkrete aktuale dhe të së ardhmes që shoqëria synon. Si i tillë, juridiksioni dhe institucioni që e ushtron atë, janë në funksion të realizimit të dizajnit kushtetues, i cili dizajn sanksionohet me **KKos**, supremacinë (epërsinë) e së cilës e siguron vetëm organi i mandatuar për një gjë të tillë – **GJKRKS**. Në këtë kuptim, gjyqësia kushtetuese kosovare ka juridiksion lidhur me çështjet si vijon:

- kontrollin abstrakt të normave ligjore[316] dhe kushtetuese,[317] **ex ante** dhe **ex post**, përfshirë kontrollin **ex post** të vendimeve dhe dekreteve individuale të organeve qendrore si dhe rregulloret e tyre që kanë natyrë të aktit të përgjithshëm nënligjor;
- kontrollin incidental të normës, i cili mund të iniciohet nga çdo nivel i gjyqësorit në Kosovë;[318]
- konfliktin për kompetencë, që lind ndërmjet pushtetit qendror dhe autoriteteve të tjera publike në Kosovë;[319]

3. Kushtetuta, ligjet dhe aktet tjera ligjore të Republikës së Kosovës interpretohen në pajtueshmëri me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007. Në rast se ka papajtueshmëri midis dispozitave të kësaj Kushtetute, ligjeve dhe akteve të tjera ligjore të Republikës së Kosovës dhe dispozitave të marrëveshjes, kjo e fundit do të mbizotërojë".

315 Kapitulli XIV [Dispozitat Kalimtare] i **KKos**:
"Neni 146 [**Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil**]
Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj Kushtetute:
1. Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil dhe organizatat e akterët e tjerë ndërkombëtarë të mandatuar sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, kanë mandatin dhe kompetencat e përcaktuara me Propozimit Gjithëpërfshirës, duke përfshirë zotësinë juridike si dhe privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara me të.
2. Të gjitha autoritetet në Republikën e Kosovës bashkëpunojnë plotësisht me Përfaqësuesin Ndërkombëtarë Civil, organizatat dhe akterët tjerë ndërkombëtarë të mandatuar sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, dhe, ndër të tjera, i'u japin fuqi ligjore vendimeve ose akteve të tyre.
Neni 147 [**Autoriteti Përfundimtar i Përfaqësuesit Ndërkombëtarë Civil**]
Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj Kushtetute, Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil, në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, është autoriteti përfundimtar në Kosovë lidhur me interpretimin e aspekteve civile të Propozimit Gjithëpërfshirës. Asnjë autoritet i Republikës së Kosovës nuk ka jurisdiksion të rishikoj, të pakësojë ose në ndonjë mënyrë të kufizojë mandatin, kompetencat dhe detyrimet e përcaktuara në nenin 146 dhe në këtë nen".

316 Neni 113 paragrafi 2 & 5 ["Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara"] i Kushtetutës. Në literaturë, ka autorë kosovar që gabimisht mendojnë se në **Kosovë** nuk ekziston kontrolli preventiv i legjislacionit primar si dhe juridiksioni ndaj vendimeve individuale qeveritare. Cf. Dren Doli & Fisnik Korenica, "Kosovar Constitutional Court's Jurisdiction: Searching for Strengths and Weaknesses" German Law Journal Vol. 11 No. 7-8 (2010), 803-836, në fq. 809-810, 814 & 833.

317 Neni 113 paragrafi 9 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i **KKos**.

318 Neni 113 paragrafi 8 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i **KKos**.

319 Neni 113 paragrafi 3 (1) [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i **KKos**.

- vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme dhe veprimeve të ndërmarra gjatë gjendjes së tillë;[320]
- kushtetutshmërinë e referendumeve të propozuara;[321]
- përputhshmërinë e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara konform dispozitave kushtetuese, si dhe rishikimin e kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur;[322]
- kushtetutshmërinë e zgjedhjeve për Kuvend;[323]
- mbrojtjen gjithëpërfshirëse të të drejtave të autoriteteve lokale **vis-à-vis** autoriteteve qendrore;[324]
- shkeljet e pretenduara të Kushtetutës nga ana e Presidenti i Republikës;[325]
- kushtetutshmërinë e vendimeve individuale të autoriteteve publike kosovare në lidhjen me liritë dhe të drejtat e garantuara me Kushtetutës, përkatësisht të drejtën për **ankesat individuale** pas shterjes së të gjitha mjeteve juridike brenda rendit kushtetues dhe juridik të Kosovës;[326] dhe, në fund,
- çdo lëndë tjetër që si juridiksion shtesë caktohet me ligj.[327]

27.9. Llojet e vendimeve

Në vijim të ushtrimit të juridiksionit të saj si gardian e KKos, GJKRKS nxjerr dy lloje të vendimeve: vendimet meritore, që quhen **aktgjykime**, dhe vendime jomeritore, që quhen **aktvendime** dhe kanë të bëjnë me vendosjen lidhur me pranueshmërinë për shqyrtim dhe vendosje të një kontesti kushtetues. Aktgjykimet vendosin përfundimisht një kontest kushtetues, në të gjitha dimensionet e tij, pas një shqyrtimi të gjithanshëm të rrethanave të rastit. Si kategori e tretë janë vendimet e ndërmjetme (interlokutore), që kanë formën e **vendimit për masat e përkohshme**, që normohen me nenin 116.1 të KKos. Kjo dispozitë përcakton si vijon:

"Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të pariparueshme". **Ligji Nr. 03/L-121** dhe **RP** tutje opercacionalizojnë këtë dispozitë, përkundër që është mjaft e qartë.

Neni 116.1 i KKos normon efektin juridik të vendimeve. Ky nen përcakton si vijon:

"[…] Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës".

Kjo dispozitë e bën të qartë se forca juridikisht e detyrueshme e vendimeve të GJKRKS nuk përcaktohet ekskluzivisht vetëm nga cilësia e tyre përmbajtësore e brendshme dhe procedura në të cilën janë dhënë. Mbi të gjitha dhe në rend të parë, ajo forcë përcaktohet nga pozita dhe roli që ka GJKRKS si një organ shtetëror në hierarkinë e institucioneve kushtetuese me juridiksion të qartë. Kjo është kështu në të gjitha vendet që kanë modelin e llojit **kelsenian/evropian** të gjyqësisë kushtetuese, pa asnjë përjashtim. Neni 116.1 si më sipër flet për konceptin e fuqisë së përgjithshme (erga om**nes**) të vendimeve të **GJKRKS**, si akte juridike të një rëndësie superiore (sipërore) në kuadër të akteve juridike nacionale. Me këtë koncept nënkuptohet, thënë me fjalë të tjera, se vendimet e këtij organi kanë fuqi superiore (më të madhe) juridike

320 Neni 113 paragrafi 3 (3) [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i **KKos**.
321 Neni 113 paragrafi 3 (2) [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i **KKos**.
322 Neni 113 paragrafi 3 (4) [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i **KKos**.
323 Neni 113 paragrafi 3 (5) [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i **KKos**.
324 Neni 113 paragrafi 4 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i **KKos**.
325 Neni 113 paragrafi 6 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i **KKos**.
326 Neni 113 paragrafi 7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i **KKos**.
327 Neni 113paragrafi 10 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i **KKos**.

se çdo akt tjetër juridik (individual dhe i përgjithshëm) i çdo organi tjetër shtetëror apo autoriteti tjetër publik. Nga kjo dispozitë ravijëzohen tri segmente që shpërfaqen në raport me krejt ambientin e jashtëm në cilin operojnë vendimet pas miratimit të tyre:

- e para, i gjithë gjyqësori, të gjitha organet kushtetuese, individët dhe institucionet e tjera të Kosovës janë të detyruar që t'i **respektojnë** vendimet e GJKRKS;
- e dyta, i gjithë gjyqësori, të gjitha organet kushtetuese, individët dhe institucionet e tjera të Kosovës janë të detyruar që t'i **përshtatin sjelljet e tyre** konform vendimeve të GJKRKS; dhe, së fundi
- e treta, i gjithë gjyqësori, të gjitha organet kushtetuese, individët dhe institucionet e tjera të Kosovës janë të detyruar që **të zbatojnë vendimet** e GJKRKS brenda kompetencave të tyre të përcaktuara me KKos dhe ligje.

Në kushtetutë, njëjtë si në shumicën e vendeve evropiane që modelon sipas sistemit evropian/kelsenian, por dhe në vendet tjera ku kontrolli kushtetues i normave dhe i veprimit apo mosveprimit të autoriteteve shtetërore/publike është thellë i rrënjosur, të vetmet produkte që përmenden në mënyrë specifike si të detyrueshme për pushtetin gjyqësor, organet dhe personat tjerë janë produktet e GJKRKS. Kjo nuk është kështu kur bëhet fjalë për vendimet e gjyqësorit të rregullt apo për vendimet individuale të organeve të tjera të pushtetit. Ky efekt i përgjithshëm që detyron çdokënd në tri segmentet (dimensionet) e shpërfaqura si më sipër (respektimi i vendimeve, përshtatja e sjelljeve kundrejt kërkesave të vendimeve dhe zbatimi i tyre në praktikë) dallon rrënjësisht nga efektet juridike që prodhojnë vendimet kushtetuese konkrete: efekti i përgjithshëm (**erga omnes)** ka të bëj me respektin që duhet ta tregojnë të gjithë, **erga omnes**, ndaj vendimeve të GJKRKS, nga i cili derivohen edhe dy segmentet të tjera si më sipër (përshtatja e sjelljeve konform me vendimet e GJKRKS dhe zbatimi i tyre konkret nga ana e organeve që kanë kompetencë kushtetues dhe ligjore për një gjë të tillë). Kjo e bën mjaft të qartë se efekti i përgjithshëm (**erga omnes**) nuk duhet të ngatërrohet me efektin **res judicata**.

Sa i përket efekteve të tjera konkrete dhe specifike të vendimeve të kësaj gjykate, ndërkaq, vlen të theksohet se ato kanë të bëjnë me natyrën juridike të vendimeve të saj. Kjo natyrë juridike nuk përcaktohet nga asgjë tjetër më shumë se nga cilësia e tyre e brendshme dhe efekti konkret që prodhojnë në marrëdhëniet kushtetuese, si pjesë e marrëdhënieve njerëzore: në disa raste, vendimet në fjalë kanë natyrë juridike **konstituive** (transformuese), siç është rasti me vendimet meritore në procedurat e kontrollit abstrakt të normës, në të tjerat raste ato kanë karakter **deklarativ**, siç është rasti me vendimet mbi ankesat kushtetuese, kurse në disa raste të tjera ato mund të kenë edhe efekte **vërtetuese**, siç është rasti me vendimet e konfliktit për kompetencë, për kontrollin e kushtetutshmërisë së shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme dhe kështu me radhë.

Cilësia e brendshme dhe procedura në të cilën janë vendimet, sikundër mund të vërehet, kanë relevancë vetëm sa i përket efekteve juridike që lloji i caktuar i vendimeve prodhon për palët, **GJKRKS**, palët e treta dhe për ambientin e jashtëm lidhur me një çështjeje konkrete kushtetuese. Shikuar në këtë kuptim, cilësia e brendshme e një aktvendimi kushtetues nuk mund të ketë efekte të tjera pos atyre brenda vetë procedurës në të cilën është dhënë dhe vetëm sa i përket palëve në procedurë dhe interesave të tyre. Kjo është kështu në veçanti kur bëhet fjalë për vendimet e dhëna në procedurën sipas ankesës kushtetuese nga neni 113.7 i **KKos**. Në rastet kur këto vendime kanë natyrë juridike të vendimeve meritore (aktgjykimeve), atëherë gjendja ndryshon: efekti i tyre, sa i përket pjesës operative (dispozitivit), është **inter partes**, njëjtë si në rastin e aktvendimeve, kurse pjesa arsyetuese e tij përbën një **res interpretata**. Me këtë term nënkuptohet efekti juridik specifik sipas të cilit çdo organ tjetër shtetëror, përveç **GJKRKS**, detyrohet që të ndjek arsyetimin e dhënë lidhur me pjesën operative (dispozitivin) e aktgjykimit me të cilin vendoset në një rast apo mosmarrëveshje konkrete kushtetuese. Vetë dispozitivi (pjesa operative), ndërkaq, ka efekt **res judicata**, por me efekt të kufizuar ekskluzivisht për rastin dhe mosmarrëveshjen konkrete. Kjo është kështu sepse vendimet meritore të gjykatave kushtetuese, përfshirë **Kosovën**, që vendosin meritoritsht lidhur me ankesën kushtetuese kanë karakter deklarativ, përkatësisht deklarojnë

shkeljen e lirive dhe të drejtave kushtetuese, duke mos u zëvendësuar (substituar) në vend të gjyqësorit apo organit tjetër shtetëror që ka kryer shkeljen e konstatuar nga gjykata kushtetuese. Për këtë arsye është gabim i madh profesional kur aktgjykimet e **GJKRKS**, në pjesën operative konstatojnë se ky ose ai vendim i **GJSKos** (ose i ndonjë organi tjetër kosovar shtetëror) është (apo nuk është) në pajtim me këtë ose atë nen të kushtetutës.[328]

Efekti prej precedenti i vendimeve të gjyqësorit të rregullt dhe kushtetues, i njohur si **stare decisis**, gjithashtu nuk ka të bëjë me klauzolën nga neni 116.1 i KKos. Kjo bëhet edhe më e qartë nëse kihet parasysh dallimi që ekziston në mes të vendimeve meritore dhe atyre që nuk prekin meritat e çështjes kushtetuese. Në **Kosovë** ky dallim në aspektin formal bëhet përmes emërtimi të vendimeve: sikundër u tha, për vendimet në çështjet kushtetuese meritore përdoret termi **aktgjykim** kurse për ato vendime me të cilat një çështje kushtetuese nuk vendoset meritorisht përdoret termi **aktvendim**. Neni 116.1 i KKos i referohet dy llojeve të këtyre vendimeve, duke përjashtuar nga ky definim, në të njëjtën kohë, çdo vendim tjetër që GJKRKS merr jashtë ushtrimit të juridiksionit nga neni 113 i Kushtetutës. Kjo nënkupton se çdo organ, institucion, përfshirë gjyqësorin e rregullt, si dhe çdo individ në Kosovë janë të detyruar që të përulen me nderim ndaj vendimeve të GJKRKS, të miratuara gjatë ushtrimit të kompetencave nga neni 113 i KKos dhe kompetencave të tjera shtesë.

Çështja e **mendimeve mospajtuese** ka qenë një çështje mjaftë e diskutueshme gjatë draftimit të **Ligjit Nr. 03/L-121**. Autoritet ndërkombëtare të kohës fuqishëm kanë argumentuar se nuk duhet lejuar mendimet mospajtuese për shkak se një zgjidhje e tillë do të shkaktonte më tutje fragmentimin e KKos përgjatë linjave etnike, fetare dhe dallimeve të tjera. Si për çudi, kanë qenë pikërisht gjyqtarët ndërkombëtarë ata që kanë insistuar në futjen e mendimeve mospajtuese në praktikën e **GJKRKS**: ditën e dhënies së betimit më datën 26 qershor 2009 është mbajtur mbledhja e parë e GJKRKS ku është miratuar **RrP**. Menjëherë pas kësaj mbledhje, siç e kujton autori i parë i këtij libri, njëri nga tre gjyqtarët ndërkombëtar ka filluar të shpreh mosbesim ndaj shumicës së gjyqtarëve vendor, pa dallim etnie: nga frika se mos po vinte deri te mbivotimi i gjyqtarëve ndërkombëtarë, ky gjyqtar ndërkombëtar fuqishëm ka insistuar në futjen e mendimit mospajtues në **RrP**. Kjo ka ndodhur më 23 nëntor 2010 kur është bërë amendamentimi i parë i **RrP-së**.[329]

---

328 *Rasti KI 150/16. Aktgjykim. Parashtrues: Mark Frrok Gjokaj Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, CLM. nr. 11/2016, të 13 shtatorit 2016*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Prishtinë, më 31 dhjetor 2018. Nr. ref.: AGJ 1314/18:
"[…] **PËR KËTO ARSYE,** Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113 (7) dhe 116 (1) të kushtetutës, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullat 56 (1), 63 (1) (5) dhe 74 (1) të Rregullores së punës, më 19 dhjetor 2018:
VENDOS: […] II. TË KONSTATOJË me shumice votash se Aktvendimi [CLM. nr. 11/2016] i 13 shtatorit 2016 i Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Aktvendimi [AC.nr. 1579/2015] i 4 prillit 2016 i Gjykatës së Apelit të Kosovës, është në pajtueshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejte dhe të Paanshëm] të kushtetutës. […]";
Rasti KI 48/18. Aktgjykim. Parashtrues: Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit AA. nr. 52/2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të 25 nëntorit 2017 dhe Aktgjykimit A.A. U. ZH. nr. 62/2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të 7 dhjetorit 2017. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë, më 4 shkurt 2019. Nr. ref.: AGJ 1322/19:
"[…] **PËR KËTO ARSYE,** Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të kushtetutës, me nenin 20 të ligjit dhe me rregullin 59 (a) të rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 23 janar 2019, njëzëri:
VENDOS: II. TE KONSTATOJE se Aktgjykimi A.A. U.ZH. nr. 62/2017, i 7 dhjetorit 2017, i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, është në përputhshmëri me nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe në përputhshmëri me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
III. TË KONSTATOJË se Aktvendimi A.A. nr. 52/2017, i 25 nëntorit 2017, i Gjykatës Supreme te Republikës së Kosovës, është në përputhshmëri me nenin 54 te Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe në përputhshmëri me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".

329 Cf. më shumë për këtë në artikullin elokuent të autorit Visar Morina, "The Newly Established Constitutional Court in Post-Status

Vendimi për **masat e përkohshme** përbën një vendim të natyrës së përkohshme dhe urgjente me të cilin nuk zgjidhet çështja meritore, mirëpo as nuk prejudikohet zgjidhja e saj.[330] Kështu është në jurisprudencën ndërkombëtare që njeh dhe praktikon masat e përkohshme. Kështu edhe është në Kosovë me ligjet tjera procedurale, të cilat, në bazë të nenit 16 të **Ligjit Nr. 03/L-121**, zbatohen, **mutatis mutandis**, në procedurat para GJKRKS në rastet ku hasen zbrazëti juridike.[331] Kjo nënkupton se në vendimin për masat e përkohshme nuk guxon dhe nuk mund të ketë mendim mospajtues. Kjo, për fakt të keq, nuk është respektuar në jurisprudencën e hershme të GJKRKS: në rastin **Tomë Krasniqi vs. RTK dhe KEK** (2009),[332] dy gjyqtarë kanë bërë mendim mospajtues në të cilin kanë kontestuar anën procedurale dhe materiale të kërkesës dhe vendimit lidhur me kërkesën.[333] Njëri ndër këta gjyqtarë ka pasur konflikt të hapur të interesit, të cilin e ka heshtur dhe më vonë është kuptuar: bashkëshorti i saj ka shërbyer si avokat i **RTK**-së.[334]

Kosovo: Selected Institutional and Procedural Concerns". *Review of Central and East European Law* Vol. 35 Issue 2 (2010) fq. 129-158 në fq. 152-155 (ku autori flet për historinë kosovare me mendimet mospajtuese).

330 Instrumenti procedural i **masave të përkohshme** ekziston në të gjitha vendet e botës dhe në të gjitha mekanizmat gjyqësor dhe arbitral ndërkombëtar; thënë me fjalë të tjera, instrumenti i masave të përkohshme përbën një kategorie që haset në të gjitha procedurat, cilado qofshin ato (administrative, penale, civile/tregtare dhe kushtetuese), vendore dhe ndërkombëtare; vënia e tyre nga autoriteti kompetent, vendor dhe ndërkombëtar, ka për qëllim pengimin e cenimit të integritetit të çështjes kryesore që duhet të shqyrtohet dhe vendoset nga dëmtimet e pariparueshme që mund t'i shkaktohen asaj me veprimet e palëve në procedurë, palëve të treta ose nga vetë rrethanat e rastit; evitimi i dëmit të pariparueshëm që mund t'i shkaktohet integritetit të çështjes e bën definimin e masave të përkohshme si instrumente mbrojtëse më të cilat arrihet ruajtja e **status quo**-s së esencës së meritave të rastit. Cf. më shumë për instrumentin e **masave të përkohshme**, në nivel vendor, regjional dhe ndërkombëtar, në të gjitha procedurat gjyqësore dhe abritrale, historinë e lindjes së tyre dhe kuptimin aktual që ato kanë, në punimet si vijon: Benjamin Kaplan, Arthur T. von Mehren and Rudolf Schaefer, "Phases of German Civil Procedure I". *Harvard Law Review* Vol. 71 No. 7 (May, 1958), pp. 1193-1268, në fq. 1258-1261; Patricia A. Essoff, "Finland v. Denmark: A Call to Clarify the International Court of Justice's Standards for Provisional Measures" *Fordham International Law Journal* Vol. 15 Issue 3 (1991) fq. 838-878 në fq. 841, 843-844, 848-849; R. St. J. Maçdonald, "Interim Measures in International Law, with Special Reference to the European System for the Protection of Human Rights" *Max-Planck-Institut für ausländisches öffentliches Recht und Völkerrech* (1992) fq. 703-740 në fq. 704, 708-709, 717-720, 731-733; 739-740; Collins Lawrence, "Provisional and protective measures in international litigation" *Collected Courses of the Hague Academy of International Law* Vol. 234 No. 3 (1992) fq. 9-238 në fq. 23; A. A. S. Zuckerman, "Quality and Economy in Civil Procedure: The Case for Commuting Correct Judgments for Timely Judgments *Oxford Journal of Legal Studies* Volume 14 Issue 3 (Autumn 1994), fq. 353–387 në fq. 368; Christian J. Tams, "Interim Orders by the European Court of Human Rights – Comments on Mamatkulov and Abdurasulovic v. Turkey" *Zeitschrift für ausländisches öffentliches Recht und Völkerrecht* 63 (2003), fq. 681-692; Susana de la Sierra, "Provisional Court Protection in Administrative Disputes in Europe: The Constitutional Status of Interim Measures Deriving from the Right to Effective Court Protection. A Comparative Approach". *European Law Journal* Vol. 10 No. 1 (January 2004) fq. 42-60 në fq. 48; Alastair Mowbray, "A New Strasbourg Approach to the Legal Consequences of Interim Measures". *Human Rights Law Review* Volume 5 Issue 2 (2005) fq. 377–386 në fq. 380, 382; Petersmann, Ernst-Ulrich, "Human Rights, International Economic Law and 'Constitutional Justice". European Journal of International Law Vol. 19 No. 4 (2008) fq. 769-798 në fq. 788-792; Yves Haeck**,** Clara Burbano Herrera and Leo Zwaak, Strasbourg's Interim Measures Under Fire: Does the Rising Number of State Incompliances with Interim Measures Pose a Threat to the European Court of Human Rights? *European Yearbook on Human Rights* Vol. 11 (March 1, 2011) fq. 375-403.

331 Neni 16 ["Rregulli i përgjithshëm"] **Ligjit Nr. 03/L-121**:
"1. Dispozitat e kësaj pjese zbatohen ndaj të gjitha procedurave gjyqësore para Gjykatës Kushtetuese, përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë ligj.
2. Në rast të mungesës së dispozitave procedurale, gjykata zbaton në mënyrë të arsyeshme dhe analoge dispozitat përkatëse të ligjeve tjera procedurale duke marrë parasysh natyrën e çështjes, si dhe veçoritë e procedurës para Gjykatës Kushtetuese".

332 *Rasti KI 11/09. Vendim. Masë e Përkohshme / MP /. Tomë Krasniqi vs. RTK ("Radio Televizioni Kosovës") dhe KEK ("Korporata Energjetike e Kosovës")*. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.** Prishtinë, më 16 tetor 2009. Akti. Nr. MP: 01/09.

333 Cf. Mendim Mospajtues. **Almiro Rodrigues**. Rasti KI 11/09. Tomë Krasniqi vs. RTK ("Radio Televizioni Kosovës") dhe KEK ("Korporata Energjetike e Kosovës"). **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. Protok. 116/09. Prishtinë, më 20 tetor 2009; Mendim Mospajtues. **Gjyljeta Mushkolaj**. Rasti KI 11/09. Tomë Krasniqi vs. RTK ("Radio Televizioni Kosovës") dhe KEK ("Korporata Energjetike e Kosovës"). **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Nr. Protok. 141/09. Prishtinë, më 23 tetor 2009. Ky, për fat të mirë, ka qenë rasti i vetëm dhe më nuk ka pasur mendime mospajtuese në vendimet e Gjykatës Kushtetuese për masë të përkohshme.

334 Cf. Vendim i Bordit për Ankesa Ref. 1503/213/BA/dk i datës 3 mars 2015. **Republika e Kosovës**. Komisioni i Pavarur i Mediave. Në këtë rast, si përfaqësues i palës ankuese, RTK, ka qenë **Naser Gjinovci**, avokat nga Prishtina, kurse vetë rasti është

28. Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë

Pjesa tetë e **KShq** i dedikohet **GJKSH-së**. Shtjellimet tona në këtë seksion ndjekin dispozitat kushtetuese shqiptare dhe legjislacionin mbi gjykatën kushtetuese. Kështu kemi vepruar edhe me organet për mbrojtjen e kushtetutshmërisë (dhe të ligjshmërisë) në vendet tjera përreth Kosovës, meqë të gjitha janë të modelit evropiano-kelsenian, me dallime të vogla në nuanca. Ngjashmëritë në juridiksion mes të gjitha gjykatave kushtetuese të rajonit, si dëshmi e **modelit evropiano-kelsenian** të përqafuar nga vendet fqinje me Kosovën, kanë qenë vendimtar për trajtimin thuajse të njëtrajtshëm të këtij organi në këto vende.

GJKSH-ja definohet si organ i gjyqësisë kushtetuese që ”zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës” (neni 124.1 i **KShq**). Kjo, sikundër shihet, e bën të qartë se GJKSH-ja nuk bën kontrollin e ligjshmërisë së akteve juridike, veprime dhe mosveprimeve të organeve të autoriteteve publike. Puna e saj ”i nënshtrohet vetëm Kushtetutës”. (neni 124.2 i **KShq**) dhe ”ka buxhet të veçantë, të cilin e administron në mënyrë të pavarur”. (neni 124.3 i **KShq**). Nga ky përcaktim kushtetues, qartë shihet se **GJKSH-ja** ka fizionomi të gjykatës kushtetuese të modelit evropian/kelsenian, sepse ka dy komponente kryesore: një, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kushtetuese në shkallë të parë dhe të bëjë këtë përkushtim në nenin e fundit; dhe, dy, interpretimin e **KShq-së**. Në dy këto komponente ajo paraqitet si aktor i vetëm me monopol të plotë. Këtë përkushtim e përsëritë në tërësi ligji organik shqiptar që përcakton rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Gjykatës Kushtetuese, statusin e gjyqtarit, paraqitjen e kërkesave dhe shqyrtimin e tyre, parimet dhe rregullat e gjykimit kushtetues, marrjen e vendimeve dhe ekzekutimin e tyre – **Ligji për Gjykatën Kushtetuese** (LGJKSH-së).[335] Ky ligj e shpreh këtë përkushtim në nenin 2 me një paragrafë të vetëm. KShq edhe më shumë reflekton këtë fizionomi të organit shqiptar të gjyqësisë kushtetuese, në pjesën që normon caktimin e gjyqtarëve, kualifikimet e tyre dhe cilësitë tjera që duhet t’i kenë gjyqtarët kushtetues (neni 125 i **KShq**), duke i lënë hapësirë shtesë **LGJKSH-së** dhe rregullativës së brendshme për operacionalizim të mëtutjeshëm të kushteve dhe cilësive që kërkohen prej gjyqtarëve kushtetues.

GJKSH-ja përbëhet nga 9 anëtarë. Tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi dhe tre anëtarë zgjidhen nga Gjykata e Lartë. Anëtarët përzgjidhen ndërmjet kandidatëve të renditur në tri vendet e para të listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas ligjit (neni 125.1 i KShq). Kuvendi zgjedh gjyqtarin kushtetues me jo më pak se tri të pestat e të gjithë anëtarëve të tij. Nëse Kuvendi nuk zgjedh gjyqtarin brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kandidati i renditur i pari në listë shpallet i emëruar (neni 125.2 i KShq). Gjyqtarët kushtetues qëndrojnë në detyrë për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi (neni 125.3 I KShq). Gjyqtarët e GJKSH-së duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës (neni 125.4 i **KShq**). Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues rregullohen me ligj (neni 125.5 i **KShq**). Përbërja e **GJKSH-së** përtërihet çdo 3 vjet me një të tretën e saj, sipas procedurës së përcaktuar me ligj (neni 125.6 i KShq). Sipas nenit 125.7 të **KShq**, gjyqtari kushtetues vazhdon në detyrë deri në zgjedhjen e

animuar në vitin 2010, pikërisht në kohën kur është trajtuar rasti i RTK-së në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe është vënë mendimi mospajtues nga bashkëshortja e avokatit **Naser Gjinovci**, gjyqtarja **Gjyljeta Mushkolaj**. Në internet: http://www.kpm-ks.org/materiale/ dokument/ 1426689009.8373.pdf (shikuar në janar 2023).

335 LIGJ Nr. 8577, datë 10.2.2000 PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË *(Ndryshuar me ligjin nr. 99/2016, datë 6.10.2016; ndryshuar me ligjin nr. 45/2021, datë 23.3.2021) (i përditësuar)*.

pasardhësit të tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 127, paragrafi 1, nënparagrafët "c" (kur jep dorëheqjen), "ç" (shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 128 të KShq, që diskutohen më poshtë), "d" (vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit; kjo nënkupton se as që ka pasur gjyqtar kushtetues sipas përcaktimeve kushtetuese, prandaj nuk mund të ketë as vazhdim të mandatit sepse ai nuk është themeluar asnjëherë) dhe, së fundi, "dh" (vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën).

Sa i përket imunitetit, **KShq** përcakton, ngjashëm si në Kosovë, **imunitetin material**: gjyqtari i **GJKSH-së** gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrim të funksioneve të tij, përveç rasteve kur ai ka vepruar për një interes vetjak ose me keqbesim (neni 126 i **KShq**). Lirimi nga përgjegjësia i gjyqtarit kushtetues, sikundër shihet, nuk vlen për rastet kur ajo/ai ka vepruar për një interes vetjak ose me keqbesim. Problemi që shtrohet këtu lidhet me atë se kush vërteton, në çfarë procedure, nëse gjyqtari ka vepruar si më sipër, rrethanë që përjashton shfrytëzimin e privilegjit të imunitetit material. Duhet të supozohet se kjo përbën një rrethanë objektive, që vërtetohet me një vendim gjyqësor të formës së prerë, në një procedurë të ligjshme, të drejtë dhe të paanshme me karakter juridiko-penal.

Neni 127 i **KShq** tregon kur mbaron mandati i gjyqtarit kushtetues (parag. 1). Ai mandat mbaron kur gjyqtari kushtetues: mbush moshën 70 vjeçare; përfundon mandatin 9-vjeçar; jep dorëheqje; shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 128 të **KShq**, që sqarohen në vijim; vërtetohen kushtet e pazgjidhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit; vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën. Një stipulim mjaft specifik ekziston në paragrafin e dytë të këtij neni, i cili thekson se "mbarimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese deklarohet me vendim të Gjykatës Kushtetuese". Kjo nënkupton se mbarimi mandatit quhet i vlefshëm ligjërisht vetëm kur një gjë e tillë konstatohet nga **GJKSH-ja**. Në rast se vendi i gjyqtarit mbetet vakant, organi i emërtesës emëron një gjyqtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të gjyqtarit të larguar (neni 127.3 i **KShq**).

Siç kemi konstatuar edhe më herët, **imuniteti** (material dhe procedural) nuk mbron gjyqtarin kushtetues nga **përgjegjësia disiplinore**. Kjo vlen edhe për **KShq**, e cila këtë dimension e bën të qartë në nenin 128. Paragrafi i parë i këtij neni saktëson se gjyqtari kushtetues mban përgjegjësi disiplinore sipas ligjit.[336] Në paragrafin e dytë saktësohen situatat kur GJKSH-ja vendos për shkarkim-

[336] Neni 10 i **LGJKSH**:
"Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mban **përgjegjësi disiplinore**, veçanërisht për shkaqe të:
1.Mosparaqitjes së kërkesës për heqje dorë nga procedimi apo gjykimi i çështjes, kur kjo është e detyrueshme, sipas ligjit procedural dhe gjyqtari është në dijeni të rrethanave të tilla.
2.Sjelljes, akteve dhe veprimeve të tjera të gjyqtarit që krijojnë përfitime të padrejta ose dëme për palët pjesëmarrëse në gjykim.
3.Mosnjoftimit të Kryetarit të Gjykatës ose të organeve kompetente, sipas ligjit, për ndërhyrjet apo ushtrimin e formave të tjera të ndikimit të papërshtatshëm nga avokatët, funksionarët politikë, funksionarët publikë dhe subjekte të tjera.
4.Ndërhyrjeve ose çdo lloj ndikimi tjetër të papërshtatshëm në ushtrimin e detyrës të një gjyqtari tjetër.
5.Mosnjoftimit të Kryetarit dhe të institucioneve përgjegjëse për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, të rasteve të papajtueshmërisë për ushtrimin e funksionit të tij.
6.Mospërmbushjes së pajustifikuar e në mënyrë të qëllimshme ose të përsëritur, përkatësisht të funksionit të tij.
7.Paraqitjes së kërkesës për heqje dorë dhe kryerjes së atyre veprimeve që nuk bazohen në shkaqet e parashikuara në ligj ose që bëhen në mënyrë të qëllimshme për të krijuar përfitime të padrejta për palët dhe të tretët, ose kur synojnë të shmangin gjyqtarin nga detyrimi ligjor për shqyrtimin e çështjes ose synojnë të krijojnë mundësinë e shqyrtimit të saj nga gjyqtarët të tjerë ose kur dorëheqja jepet e vonuar megjithëse ka qenë në dijeni të faktit për të cilin jep dorëheqjen.
8.Shkeljes së përsëritur ose të rëndë të rregullave të solemnitetit dhe rregullave të sjelljes në marrëdhëniet me pjesëmarrësit në proces, si edhe me gjyqtarë ose administratën e Gjykatës Kushtetuese.
9.Vonesës dhe zvarritjes së përsëritur dhe të pajustifikuar të veprimeve procedurale dhe gjatë ushtrimit të funksionit.
10.Bërjes publike të mendimeve që ka dhënë vetë ose gjyqtarët e tjerë gjatë procesit që akoma nuk kanë marrë formën e një akti të bërë publik.
11.Shkeljes së detyrimit të konfidencialitetit dhe të mospërhapjes së informacionit, që rezultojnë nga hetimi ose gjy-

in e gjyqtarit kushtetues: kur ajo konstaton shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të mandatit apo kur gjyqtari dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi. Përveç shkarkimit, ky nen normon edhe kategorinë e **pezullimit** të gjyqtarit kushtetues. Deri te pezullimi nga detyra me vendim të **GJKSH-së** vjen kur ndaj gjyqtarit caktohet masa e sigurimit personal "arrest në burg" ose "arrest në shtëpi" për kryerjen e një vepre penale; kur gjyqtari merr cilësinë e të pandehurit për një krim të kryer me dashje; dhe, së fundi, ndaj saj/tij fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.

Pasi konstaton se mandati i gjyqtarit kushtetues nis me dhënien e betimit (neni 129), **KShq** normon **papajtueshmërinë** e funksionit të gjyqtarit kushtetues me funksionet dhe punë të tjera: qenia gjyqtar kushtetues nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike, shtetërore, si dhe me veprimtari profesionale që ushtrohen kundrejt pagesës, me përjashtim të atyre të mësimdhënies, akademike dhe shkencore, sipas ligjit (neni 130).

Neni në vijim, nenin 131 i **KShq** në tërësi kushtohet **juridiksionit** të **GJKSH-së**. Në vijim po e japin këtë nen ashtu siç figuron në KShq, me fusnotat tona për aq sa kjo ka nevojë për sqarim të referimeve kryqëzore që i ka bërë kushtetutëbërësi shqiptar. Në këtë nen thuhet se GJKSH-ja vendos për sa vijon:

a) pajtueshmërinë e ligjit me **KShq** ose me marrëveshjet ndërkombëtare, siç parashikohet në nenin 122;[337]
b) pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me **KShq** para ratifikimit të tyre (kontrolli preventiv i marrëveshjeve ndërkombëtare);
c) pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me **KShq** dhe me marrëveshjet ndërkombëtare;
ç) mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore;
d) kushtetutshmërinë e partive dhe të organizatave të tjera politike, si dhe të veprimtarisë së tyre, sipas nenit 9 të **KShq**; [338]

kimi, në proces apo i përfunduar, duke përfshirë lehtësinë e publikimit dhe shpërndarjes, gjithashtu edhe për shkak të neglizhencës, të akteve konfidenciale ose akteve procedurale ose informacioneve konfidenciale që rrjedhin nga çështjet të cilat janë në proces hetim ose gjykimi.
12.Bërjes së deklaratave publike dhe në media, për çështjet, me përjashtim të komunikimeve të shtypit brenda kufijve të detyrës së tij.
13.Parashtrimi të shtrembëruar të fakteve në aktet e nxjerra.
14.Përdorimit të mandatit të gjyqtarit, me qëllim për të realizuar përftime të pajustifikuara ose përfitime për vete ose për të tjerët.
15.Shoqërimit me persona që janë nën ndjekje penale ose janë subjekte të një procedimi penal, ose me persona të dënuar penalisht, përveç rasteve të rehabilitimit të personave të dënuar, ose persona të cilët janë të afërm me gjyqtarët në lidhje gjaku ose me ligj, dhe pasja e marrëdhënieve biznesi të papërshtatshme me këta persona.
16.Përfitimit të padrejtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale të çfarëdo lloji, të cilat, qoftë edhe me anë të veprimeve të ligjshme, i jepen për shkak të funksionit që ushtron ose si rrjedhojë e përdorimit prej tij të pozicionit të magjistratit.
17.Sjelljes së papërshtatshme në përmbushjen e detyrimeve, në marrëdhëniet dhe në komunikimin me institucionet shtetërore dhe funksionarët e tyre, dhe raste të tjera me sjellje të papërshtatshme të pajustifikuar".

337 Neni 122 i **KShq**:
"1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë.
2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.
3. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj".

338 Neni 9 i **KShq**:

dh) shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës dhe vërtetimin e pamundësisë së ushtrimit të funksioneve të tij;
e) çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës, të deputetëve, të funksionarëve të organeve të parashikuara në **KShq**, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre;
ë) kushtetutshmërinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij;
f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në **KShq**.

Paragrafi i dytë saktëson se në rastet kur **GJKSH-ja** "vihet në lëvizje për shqyrtimin e një ligji për rishikimin e KShq, të miratuar nga Kuvendi sipas nenit 177,[339] atëherë ajo kontrollon vetëm respektimin e procedurës së parashikuar nga KShq".

Pas juridiksionit, në nenin në vijim, nenin 132, **KShq** normon **natyrën juridike të vendimeve** të **GJKSH-së**. Në tre paragrafë sqarohet se vendimet e **GJKSH-së** janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim (parag. 1). Ato hyjnë në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ngjashëm më praktikën e përhapur të gjyqësisë kushtetuese të modelit evropiano-kelsenian, edhe **GJKSH-së** mund të urdhërojë që vendimi i saj, me të cilin ka shqyrtuar kushtetutshmërinë e aktit, të fillojë efektet në një datë tjetër (parag. 2). Në paragrafin e fundit normohet kategoria e mendimit mospajtues, diçka shumë e rëndësishme sepse gëzon status kushtetues dhe jo si një rregullativë e brendshme. Mendimi i pakicës publikohet bashkë me vendimin përfundimtar (parag. 3). Ngushtësisht e lidhur me këtë është çështja vendimmarrjes: neni në vijim gjithashtu flet për vendimet, por tani në kuptim të vendimmarrjes, mënyrës sipas së cilit prodhohen ato. Në këtë kontekst, KShq normon vendimet mbi pranueshmërinë dhe vendimet mbi meritat e rastit, që nënkupton se mënyrën bazike të vendimmarrjes e ngritë në nivel të garancionit kushtetues: **pranueshmëria** e kërkesave për gjykim vendoset nga një numër gjyqtarësh, siç përcaktohet me ligj (neni 133.1 i **KShq**).[340] Sa i përket vendimeve meritore, të cilat kushtetutëbërësi shqiptar i quan **vendime përfundimtare**, **GJKSH-ja** i merr ato me shumicën e të gjithë anëtarëve të saj, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj (neni 133.2 i **KShq**).[341]

Neni i fundit i pjesës që flet për **GJKSH-në**, neni 134, normon vënien e saj në lëvizje, duke përjashtuar vënien në lëvizje **sua sponte** (me vetëiniciativë). Kjo është e kuptueshme, nisur nga fakti se gjyqësia kushtetuese shqiptare është e re dhe nuk ka lindur, si në ish-Jugosllavi, në kontekstin e zhvillimit kushtetues komunist por pas rrëzimit të regjimit të tillë komunist, që kishte tipare të theksuara të stalinizmit. Edhe këtu japim përshkrimin e dispozitave të këtij neni ashtu si gjenden në **KShq**, duke vënë në fusnotë referimet kryqëzore të kushtetutëbërësit shqiptar. Në paragrafin e parë të këtij neni thuhet se **GJKSH-ja** vihet në lëvizje me kërkesë të subjekteve për sa vijon:

a) Presidentit të Republikës;
b) Kryeministrit;

"1. Partitë politike krijohen lirisht. Organizimi i tyre duhet të përputhet me parimet demokratike.
2. Partitë politike dhe organizatat e tjera, programet dhe veprimtaria e të cilave mbështeten në metoda totalitariste, që nxitin e përkrahin urrejtjen racore, fetare, krahinore ose etnike, që përdorin dhunën për marrjen e pushtetit ose për të ndikuar në politikën shtetërore, si edhe ato me karakter të fshehtë janë të ndaluara sipas ligjit.
3. Burimet financiare të partive, si dhe shpenzimet e tyre bëhen kurdoherë publike".

339 Bëhet fjalë për projektligjin për rishkimin e KShq, që mund të miratohet me votat e shumicës së kualifikuar të deputetëve në Kuvend (dy të tretat e krejt deputetëve), apo me referendum. Kjo procedurë strikte nuk guxon të shkelet, prandaj **GJKSH** ka kompetencë për vlerësim të kushtetushmërisë së kësaj procedure të përcaktuar me këtë nen.

340 Neni 31 **LGJKSH-ja** rregullon në mënyrë të detajuar procedurën e vendosjes për pranueshmërinë e kërkesës.

341 Neni 47.3 i **LGJKSH** urdhëron shpalljen e vendimit përfundimtar, me arsyetim, jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i seancës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj. Rastet e tilla përcaktohen me dipsozitat e kreut VII të **LGJKSH-s[** që normon procedurat e veçanta të kontrollit të kushtetutshmërisë.

c) jo më pak se një të pestës së deputetëve;
ç) Avokatit të Popullit;
d) Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit;
dh) çdo gjykate, sipas nenit 145, pika 2, të KShq;[342]
e) çdo komisioneri të krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga KShq;
ë) Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
f) organeve të qeverisjes vendore;
g) organeve të bashkësive fetare;
gj) partive politike;
h) organizatave;
i) individëve.

Paragrafi i dytë këtij neni saktëson çështjet për të cilat subjektet e caktuara mund iniciojnë procedurën pranë **GJKSH-së: "**Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët "d", "dh", "e", "ë", "f", "g", "gj", "h" dhe "i", të paragrafit 1, të këtij neni, mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre".

29. Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut

Edhe në **Maqedoninë e Veriut** ekziston gjyqësi evropiano-kelseniane, me një gjykatë të ndarë kushtetuese, që funksionon jashtë sistemit të gjyqësorit të rregullt, e mbushur me gjyqtarë kushtetues, që nuk janë të karrierës. **KMVe** në mënyrë të qartë e përcakton këtë fizionomi të **GJKMVe** në dispozitat e kapitullit të katërt (nenet 108-113) të **KMVe**. Për dallim nga vendet tjera përreth Kosovës, në Maqedoninë e Veriut nuk ekziston një ligj i posaçëm për gjykatën kushtetuese: mënyrën e punës dhe procedurën pranë **GJMVe** normohet me Rregullat e Procedurës (RPGJKMVe).

GJKMVe është organ i cili mbron kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë dhe përbëhet nga nëntë gjyqtar (nenet 108 dhe 109.1 të **KMVe**). Sikundër shihet, definicioni ngërthen edhe mbrojtjen e ligjshmërisë, në ndërkohë që përcaktimi i fizionomisë së organit është më gjithëpërfshirës se në rastin e KShq. **GJKMVe** ka lindur në ish-**Jugosllavi**, në vitin 1963, si pjesë e formimit të gjyqësisë kushtetuese në atë shtet, pjesë e të cilit ka qenë edhe **Kosova**, si në nivelin federal ashtu edhe në nivel të republikave dhe krahinave autonome.

Gjyqtarët e **GJKMVe** i zgjedh Kuvendi me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me mandate që zgjat nëntë vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje. Me paragrafin e parë të amendamentit **XV** në **KMVe** të datës 16 nëntor 2001, Kuvendi zgjedh tre gjyqtarë me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me ç'rast medoemos duhet të ketë shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u takojnë bashkësive të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë. Kjo dispozitë është e ngjashme me dispozitën e **KKos**, që kërkon pëlqimin e komuniteteve joshumicë për zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues dhe përfaqëson një formë të demokracisë konsociacionale në Maqedoninë e Veriut. Ndryshe njihet edhe si **parimi Badinter**. **GJKMVe** nga radhët e veta zgjedh kryetarin me kohëzgjatje prej tre vjetësh dhe pa të drejtë rizgjedhjeje. Gjyqtarët kushtetues zgjidhen nga radhët e juristëve të shquar (neni 109 parag. 2-4 i KMVe). Nga këto përcaktime kushtetuese vërehet se modeli evropiano-kelsenian në tërësi ka gjetur shprehje: gjyqtarët kushtetues nuk janë gjyqtarë karriere, por jurist të shquar, pa të drejtë rizgjedhje me qël-

[342] Neni 145.2 i **KShq**:
"Kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjitha gjykatat". Pra, sikundër shihet, këtu bëjhet fjalë për **kontroll incidental**, ngjashëm si në Kosovë dhe vendet tjera që kultivojnë gjyqësi kushtetuese **evropiano-kelseniane**. Kjo kompetencë e gjykatave kushtetuese përfaqëson një relikt nga modeli i decentralizuar i kontrollit të kushtetutshmërisë të vendeve të sistemit amerikan të gjyqësisë kushtetuese, ku secila gjykatë ka kompetencë për të bërë ushtrimin e kushtetutshmërisë, mirëpo fjalën përfundimtare, edhe këtu, e ka instanca më e lartë gjyqësore ne vend, kurse vendimet e instancave më të ulëta kanë efekt të kufizuar **inter partes** dhe vetëm për rastin dhe mosmarrëveshjen në të cilën ka lindur dhe është vendosur çështja kushtetuese.

lim të ruajtjes së pavarësisë së tyre kundrejt organit politik që bën zgjedhjen e tyre – **Kuvendi Maqedonisë së Veriut.**

Neni 110 përcakton juridiksionin e **GJMVe**, i cili është i ngjashëm me juridiksionin e gjykatave kushtetuese të ish-republikave jugosllave. Sipas këtij përcaktimi kushtetues, kjo gjykatë:

- vendos për përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën;
- vendos për përputhshmërinë e rregullave të tjera dhe të marrëveshjeve kolektive me KMVe dhe me ligjet e vendit;
- i mbron liritë dhe të drejtat e njeriut e të qytetarit, që kanë të bëjnë me lirinë e bindjes, ndërgjegjjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimeve, bashkimin dhe veprimin politik dhe ndalimin e diskriminimit të qytetarëve mbi bazë të gjinisë, racës, fesë, përkatësisë kombëtare, sociale dhe politike;
- vendos për konfliktin e kompetencave midis bartësve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor;
- vendos për konfliktin e kompetencave midis organeve të Republikës dhe njësive të vetëadministrimit lokal;
- vendos për përgjegjësinë e Presidentit të Republikës;
- vendos për kushtetutshmërinë e programeve dhe statuteve të partive politike dhe të shoqatave civile; dhe, së fundi,
- vendos edhe për çështje të tjera të përcaktuara me KMVe.

Në një nen të vetëm, në nenin 111, **KMVer** rregullon çështjen e papajtueshmërisë, imunitetit, lirimit nga detyrimi ushtarak i gjyqtarit kushtetues, pushimi dhe shkarkimi nga funksioni i gjyqtarit kushtetues. Funksioni gjyqtar i **GJKMVe** nuk pajtohet me ushtrimin e funksionit dhe profesionit tjetër publik ose me anëtarësimin në parti politike, thuhet në paragrafin e parë të nenit në fjalë. Paragrafi dytë saktëson se gjyqtarët kushtetues gëzojnë imunitet, për fatin e të cilit vendos vetë **GJKMve**. Nga kjo dispozitë nuk shihet qartë se për çfarë imuniteti bëhet fjalë. Këtë e gjejmë në dispozitën e nenit 10 të **RPGJKMVe**, e cila thotë se imuniteti është i njëjtë me imunitetin e deputetëve të garantuar me **KMVe**. Në po këtë dispozitë të **RPGJKMVe** gjenden të sanksionuara si imuniteti procedural ashtu edhe ai material. Një dispozitë e çuditshme gjendet në paragrafin e tretë të KMVe sa i përket gjyqtarëve kushtetues dhe raportit të tyre me ushtrinë: ata nuk i nënshtrohen detyrimit në forcat e armatosura, thuhet në këtë paragraf. Gjyqtarit kushtetues i pushon funksioni nëse paraqet dorëheqje (parag. 4 i **KMVe**), kurse shkarkohet nga detyra nëse dënohet për vepër penale me dënim të pakusht me burg me më së paku gjashtë muaj ose kur përgjithmonë humb aftësinë për ushtrimin e funksionit të tij. Dy këto rrethana verifikohen me vendim të posaçëm nga **GJKMVe** (parag. 5 i **KMVe**).

Dy nenet e fundit i kushtohen vendimmarrjes dhe autonomisë normative të GJMVe. Në nenin 112.1 përcaktohet GJMVe do të abrogojë ose shfuqizojë ligjin nëse konstaton se nuk është në përputhje me KMVe, kurse dispozitat e paragrafit të dytë të nenit të njëjtë ka të bëj me të njëjtën gjë, por në raport me aktet juridike me fuqi më të ulët se ligji: **GJKMVe** do të abrogojë ose shfuqizojë rregull tjetër ose akt të përgjithshëm, marrëveshje kolektive, statut apo program të partisë politike ose të shoqatës, nëse konstaton se të njëjtat nuk janë në përputhje me **KMVe** ose me ligjin. Vendimet e **GJKMVe** janë të formës së prerë dhe të ekzekutueshme, thuhet në paragrafin e tretë të nenit 112 të **KMVe**. Vetë cilësimi i vendimeve të **GJMVe** si të formës së prerë dhe të ekzekutueshme nënkupton që për vënien e tyre në jetë, të të drejtave dhe detyrimeve që dalin nga to për subjektet e së drejtës, kujdeset forca e shtetit që garanton zbatimin e tyre. Njëjtë është edhe në **Shqipëri**, ku Këshilli Ministrave lajmërohet si garant i zbatimit të vendimeve të **GJKShq**, në ndërkohë që në **Kosovë** nuk ekziston një garancion i tillë kushtetues dhe as një organ shtetëror që kujdeset për zbatimin e vendimeve të **GJKRKS**. Për dallim nga **Shqipëria** ku si garant i zbatimit të vendimeve paraqitet një organ qendror shtetëror, në **Maqedoninë e Veriut**, ky garancion kushtetues ka **dimension juridiko-penal**, që do të thotë se shteti zbaton sanksion penal për rastet e moszbatimit të vendimeve të GJKMVe. Shënojmë me këtë rast se në përgjithësi në modelin evropiano-kelsenian nuk përcaktohet një mbrojtje **penalo-juridike** e vendimeve të gjykatave kushtetuese, dhe as ndonjë organ shtetëror si garantues i vënies së tyre në jetë.

30. Gjykata Kushtetuese e Malit të Zi

Gjyqësia kushtetuese malazeze është themeluar në vitin 1963, në ndërkohë që puna e **GJKMZi** ka nisur në vitin 1964, njëjtë si në Maqedoninë e Veriut. Rolin e vet të garantuesit institucional të gjyqësisë kushtetues, **GJKMZi** e ka realizuar në kushtet e ndryshimeve të shpeshta kushtetuese dhe nën sisteme të ndryshme socio-politike, fillimisht në kushtet e shtetit federal komunist (RSFJ), më pas në shtet federal jokomunist me dy shtete anëtare, i njohur si Republika Federale e Jugosllavisë (RFJ: Serbi-Mali i Zi), i cili në vitin 2002 u riemërtua si Bashkësia Shtetërore Serbi – Mali i Zi. Ky shtet u shpërbë në vitin 2006, kur Mali shpalli pavarësinë e vet nga Serbia dhe u bë shtet sovran dhe i pavarur. Nga kjo rrjedh se, për pasojë, shikuar nga prizmi i zhvillimit kushtetues, në **Mal të Zi** kanë ekzistuar tri periudha të zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese. Periudha e parë përfshinë gjyqësinë kushtetuese nën ish-Jugosllavinë komuniste, nga vitit 1963 deri në vitin 1962. Në këtë kohë, **Mali i Zi** ka qenë njëra prej gjashtë republikave jugosllave. Këtë periudhë e karakterizon drejtimi socialist i zhvillimit shoqëror, shteti i përbashkët dhe forma federative e tij, sovraniteti i popullit punonjës socialist, pronësia shoqërore, pushteti dhe vetëqeverisja e proklamuar e klasës punëtore, i popullit punues dhe fshatarëve, barazia e kombeve dhe kombësive, roli kryesor drejtues dhe komandues i partisë komuniste dhe kështu me radhë. Kjo ka qenë e njëjtë për të gjitha republikat dhe krahinat autonome. Periudha e dytë përfshinë gjyqësinë kushtetuese brenda RFJ (Serbi – Mali i Zi), nga viti 1992 (kur u themelua ky shtet dyanëtarësh) e deri në vitin 2002 (kur u ridefinua si Bashkësia Shtetërore Serbi – Mali i Zi). Këtë periudhë e karakterizoj hedhja poshtë e rrugës socialiste të gjyqësisë kushtetuese dhe kalimi në një shoqëri pluraliste, ku synohet sundimi i ligjit, liritë dhe të drejtat e individit, tregu i lirë dhe organizimi i hapur politik. Faza e fundit nis me pavarësimin e vendit në vitin 2006 dhe karakterizohet me restaurimin e shtetësisë së humbur të Malit të Zi dhe ndërtimin e një sistemi juridik sipas standardeve evropiane. Me **KMZi** të vitit 2007, aktualisht në fuqi, **GJKMZi** themelohet si një organ i posaçëm, i ndarë nga pushtetet tjera, që mbron kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, përkatësisht rendin kushtetues dhe supremacinë e **KMZi**, me fokus të madh në mbrojtjen dhe garantimin e lirive dhe të drejtave kushtetuese. Risia më e madhe me **KMZi** të vitit 2007 është futja e mbrojtjes së drejtpërdrejtë të lirive dhe të drejtave të njeriut përmes ankesës kushtetuese.

KMZi normon organin e gjyqësisë kushtetuese, **GJKMZi**, në pjesën e gjashtë (nenet 149 – 154) dhe nis me përcaktimin e juridiksionit të këtij organi. Fizionomia e tij evropiano-kelseniane prej organit të gjyqësisë kushtetuese përcaktohet me nenin 11.6 të dispozitave themelore të KMZI që normojnë ndarjen e pushtetit, njëjtë si në nenin 4. 6 të KKos, në të cilin thuhet se "kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e mbron Gjykata Kushtetuese". Krahas KMZi, **Ligji për Gjykatën Kushtetuese** (LGJKMZi) rregullon procedurën e caktimit të gjyqtarëve kushtetues, shkarkimin dhe përfundimin e funksionit të tyre, organizimin e GJKMZi, procedurën pranë GJKMZI, efektin juridik të vendimeve të saj dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e GJKMZi.

GJKMZi, bazuar në nenin 149 që rregullon kompetencën e saj, ka këto autorizime:

- vendos mbi pajtueshmërinë e ligjeve me KMZI dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe publikuara;
- vendos mbi pajtueshmërinë e dispozitave të tjera dhe akteve të përgjithshme me KMZi;
- vendos mbi ankesën kushtetuese lidhur me shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut të garantuara me KMZi, pas shterjes së mjeteve të gjitha mjeteve efektive juridike;
- vendos nëse presidenti Malit të Zi ka shkelur KMZi;
- vendos mbi konfliktin për kompetencë mes gjykatave dhe organeve të tjera shtetërore, mes organeve shtetërore dhe njësive të vetëqeverisjes lokale dhe mes organeve të njësive të vetëqeverisjes lokale;
- vendos mbi ndalimin e partisë politike dhe organizatës joqeveritare;
- vendos mbi kontestet zgjedhore dhe kontesteve lidhur me referendumin, të cilat nuk bien në kompetencën e organeve të tjera;

- vendos mbi pajtueshmërinë me KMZi të masave dhe veprimeve të organeve shtetërore, të ndërmarra gjatë në kohë të luftës dhe gjendjes së jashtëzakonshme;
- vendos edhe për çështje të tjera të përcaktuara me KMZi.

Në paragrafin e dytë të këtij neni rregullohet situata kur një dispozitë ose akt juridik ka humbur fuqinë juridike, por kanë ngelur prapa pasojat nga zbatimi tyre, në ndërkohë që GJKMZi ka vendosur për kushtetutshmërinë ose ligjshmërinë e tij. Në një rast të tillë, kjo dispozitë autorizon GJKMZi që të vendos lidhur me pasojat në fjalë përkatësisht të tregoj nëse gjatë kohë së zbatimit të tyre kanë qenë akte juridike kushtetues, përkatësisht ligjore. Për pasojë, me këtë veprim GJKMZi vendos edhe për modalitetet e mënjanimit (largimit) të pasojave që kanë shkaktuar aplikimet e akteve që janë shpallur si jokushtetuese, përkatësisht joligjore. Në paragrafin e fundit të këtij neni, GJKMZi autorizohet për të përcjellë gjendjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në vend dhe për këtë të njoftoj Kuvendin e Malit të Zi. Kjo kompetencë është relikt i të kaluarës komuniste, kur gjyqësia kushtetuese në tërësi ka qenë e varur nga kuvendet e republikave dhe krahinave autonome dhe, në nivel federal, nga Kuvendi i ish-Jugosllavisë. Kjo përcjellje e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë dhe raportimi në kuvend për këtë gjendje, dikur bëhej për shkak se të gjitha organet shtetërore kanë qenë në shërbim të ndërtimit të **kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë komuniste** të dirigjuar nga **partia komuniste** në pushtet, e cila ka pasur monopol të garantuar kushtetues mbi krejt pushtetin shtetëror. Për pasojë, rezulton se gjyqësia kushtetuese duhet të mbroj kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë përmes vendimeve meritore individuale lidhur me rastet dhe mosmarrëveshjet konkrete (kontestet kushtetuese), jo të luaj rolin e raportuesit të gjendjeve shoqërore. Kjo për shkak se ajo nuk ka kapacitet institucional, njerëzor, logjistikë dhe mekanizma të tjerë të përcjelljes së dukurive që zhvillohen në shoqëri, përfshirë gjendjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë.

Në nenin 150, **KMZi** normon vënien në lëvizje të procedurës për vlerësim të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Këtë e bën në katër paragrafë. I pari paragraf autorizon çdo kënd, secilin subjekt të së drejtës, për të iniciuar fillimin e procedurës për vlerësim të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Ky inicim, megjithatë, nuk nënkupton cilësinë e palës së autorizuar procedurale pranë GJKMZi. Se kjo është kështu, bëhet e qartë në paragrafin e dytë, në të cilin specifikohen subjektet e autorizuara, të cilat legjitimohen si palë në procedurë. Përveç kësaj, edhe **LGJKMZi**, në nenin 30 të dispozitave të përgjithshme, bën dallimin në mes të parashtresave me të cilat vihet në lëvizje procedura pranë GJKMZi dhe parashtresave të tjera me të cilat iniciohet vënia në lëvizje e procedurës.[343] Sa i përket subjekteve, ndërkaq, vetëm **KMZi** përcakton qartë se cilat janë ato. Këtë e bën në paragrafin e dytë të nenit si më sipër. Ato janë gjykatat, organi tjetër shtetëror, organi vetëqeverisjes lokale dhe pesë deputetë. Njëjtë si dallimi mes iniciativës për vënie në lëvizje të procedurës dhe kërkesës për vënie në lëvizje të procedurës, të cilën e bënë kushtetutëbërësi malazez, dallim që i takon kohës së **gjyqësisë kushtetuese komuniste**, edhe një tjetër relikt i kësaj kohe ekziston në paragrafin e tretë të këtij neni. E kemi fjalën për të drejtën e **GJKMZi** që vetë, **sua sponte**, të vëj në lëvizje procedurën për vlerësim të

[343] Neni 30 i **LGJKMZi**:
"Parashtresat me të cilat vihet në lëvizje procedura para **GJKMZi** janë:
1) propozimi për vlerësimin e pajtueshmërisë së ligjit me KMZi dhe marrëveshjet e ratifikuara dhe publikuara ndërkombëtare dhe propozimi për vlerësimin e pajtueshmërisë së dispozitave dhe akteve të tjera të përgjithshme me KMZi dhe ligjin;
2) ankesa kushtetuese për shkak të cënimit të lirive dhe të drejtave të garantuara me KMZi;
3) propozimi për vënien në lëvizje të procedurës për vërtetim nëse Presidneti i Malit të Zi ka shkelur KMZi;
4) popozimi për vendosje lidhur me konfliktin për kompetencë;
5) propozimi për ndalimin e punës partisë politike ose organizatës joqeveritare;
6) ankesa në kontestet zgjedhore dhe kontestet lidhur me referendumin.
Parashtresat me të cilat inicohet vënia në lëvizje e procedurës para GJKMZi janë:
1) iniciativa për vënie në lëvizje të procedurës për vlerësim të pajtueshmërisë së ligjit me KMZi dhe marrëveshjet e ratifikuara dhe publikuara ndërkombëtare dhe propozimi për vlerësimin e pajtueshmërisë së dispozitave dhe akteve të tjera të përgjithshme me KMZi dhe ligjin;
2) iniciativa për vënien në lëvizje të procedurës për vlerësim të pajtueshmërisë me KMZi të masave dhe veprimeve të organeve shtetërore të ndërmarra në kohën e luftës dhe gjendjes së jashtëzakonshme".

kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Paragrafi i fundit, ndërkaq, flet për të drejtën e gardianit të kushtetutës për vënien e **masave të përkohshme**, përkatësisht për pezullimin e zbatimit të aktit individual dhe dispozitave të aktit të përgjithshëm objekt kontrolli kushtetues apo për ndalimin e ndërmarrjes së ndonjë veprimi tjetër bazuar në këto akte, nëse vlerësohet se mund të prodhohen pasoja të dëmshme të pariparueshme.

Neni në vijim, neni 151 i KMZi i kushtohet vendimeve të GJKMZi, mënyrës së prodhimit dhe natyrës së tyre juridike, zbatimit dhe çështjeve të tjera rreth vendimeve të gjyqësisë kushtetuese malazeze. Paragrafi i parë përcakton se vendimet merren me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve, një qasje kjo në frymën e parimit demokratik brenda trupës së gjyqtarëve kushtetues. Vendimet e GJKMZi publikohen, thuhet në paragrafin e dytë, standard ky i të gjitha gjykatave kushtetuese të modelit evropiano-kelsenian nëpër botë. Natyra juridike e vendimeve rregullohet me paragrafin e tretë, që thotë se "vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme dhe të zbatueshme". Për dallim nga rasti KMVe, KMZI garanton zbatimin e vendimeve të GJKMZi përmes ekzekutivit të vendit, kur kjo është e nevojshme. Ky përbën një garancion të fortë kushtetues që nuk lejon zbatimin e vendimeve në mëshirën e vullnetit të lirë të subjekteve të së drejtës.

Neni 152 i **KMZi** rregullon **efektet juridike** të vendimeve të **GJKMZi**, por vetëm sa i përket atyre që kanë të bëjnë me vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së normave juridike, jo edhe të vendimeve që i referohen vlerësimit të kushtetutshmërisë së akteve individuale (sepse ligjshmërinë e akteve individuale e vlerësojnë gjykatat e rregullta). Kur GJKMZi konstaton se një ligj nuk është në pajtim me KMZi dhe marrëveshjet e ratifikuara dhe publikuara ndërkombëtare, përkatësisht kur dispozitat tjera nuk janë në pajtim me KMZI dhe ligjin, ai ligj dhe ato dispozita pushojnë së vlejturi ditën e publikimit të vendimit të GJKMZi (neni 152.1 i KMZI). Ligji ose dispozitat tjera, përkatësisht dispozitat e tij individuale për të cilat është konstatuar me vendim të GJKMZi se nuk janë në pajtim me KMZI dhe ligjin, nuk mund të zbatohen ndaj marrëdhënieve që janë krijuar para publikimit të vendimit të GJKMZi, nëse deri atë ditë atë marrëdhënie nuk kanë marrë formën e prerë (neni 152.2i KMZi).

Përbërja dhe zgjedhja e gjyqtarëve të GJKMZi në fillim ka qenë e normuar me nenin 153 të KMZi. Me amendamentin XVI të datës 31 korrik 2013 kjo ka ndryshuar. Me dispozitën e vjetër të nenit 153 ekzistonin shtatë gjyqtar kushtetues (parag.1). Ata zgjedheshin për një mandat prej nëntë viteve (parag. 2). Kryetari i GJKMZi zgjedhet për një mandat tri vjetësh nga trupa gjyqësore (parag. 3). Për gjyqtarë kushtetues mund të zgjedhej çdo kush që gëzonte autoritetin e ekspertit të mirë të drejtësisë, me përvojë së paku pesëmbëdhjetë vite pune në profesion. Si i papajtueshëm me funksionin e gjyqtarit kushtetues konsiderohej pozita e deputetit dhe çdo funksion tjetër publik, por edhe ushtrimi i veprimtarisë tjetër profesionale (parag. 4). Sikundër u tha, ky nen tani është zëvendësuar me amendamentin e sipërcekur, i cili ka shtatë paragrafë. Në paragrafin e parë sërish thuhet se GJKMZi ka shtatë gjyqtarë kushtetues. Mandati tyre tani është zgjatur në dymbëdhjetë vjet (parag. 2). Gjyqtarët kushtetues zgjidhen nga Kuvendi i Malit të Zi dhe atë si vijon: dy gjyqtarë propozohen nga Presidenti i Mali të Zi, kurse pesë të tjerë propozohen nga trupa punuese kompetente e Kuvendit. Në dy rastet shpallet konkursi, që ekzekutohet nga vetë propozuesit (parag. 3). Gjyqtari kushtetues zgjedhet nga mesi i juristëve eminent, me moshë së paku dyzetvjeçare dhe pesëmbëdhjetë vjet përvojë në profesionin e drejtësisë (parag. 4). Sikundër shihet edhe kjo është një dispozitë rrënjësisht e ndryshme nga ajo e nenit 153 të KMZi. E njëjtë ka ngelur dispozita e paragrafit të pestë, që thotë se kryetarin e GJKMZi e zgjedhin vetë gjyqtarët për një mandat trevjeçar. As kryetari e as gjyqtarët kushtetues nuk mund të rizgjidhen për një mandat tjetër (parag. 6). Edhe dispozita e paragrafit të fundit ngelet thuajse e njëjtë me paragrafin e katër të nenit të vjetër 153 të KMZi: kryetari dhe gjyqtarët e **KMZi** nuk mund të jenë deputet dhe as të ushtrojnë ndonjë funksion tjetër publik apo ndonjë veprimtari tjetër.

Neni i fundit, neni 154 i KMZi përcakton situatat që çojnë në **ndërprerjen e funksionit të gjyqtarit kushtetues**. Kryetarit të **GJKMZi** dhe gjyqtarëve të saj kushtetues iu ndërpritet mandati para kohe kur një gjë të tillë e kërkojnë vetë, kur plotësojnë kushtet për pensionin e pleqërisë, apo kur dënohen me dënim me

burg efektiv (parag. 1). Sikundër shihet, këtu një kusht specifik është ai i plotësimit të moshës së pleqërisë, që nuk është një standard i gjyqësisë kushtetuese evropiano-kelsniane, meqë gjyqtarët kushtetues nuk janë gjyqtarë karriere. Kryetari dhe gjyqtarët kushtetues shkarkohen nga detyra kur dënohen për një vepër penale që i bën të padenjë për ushtrimin e funksionit të tyre, nëse humbin aftësinë për të ushtruar funksionin në mënyrë permanente, ose kur publikisht shpreh bindjet e veta politike (parag. 2). Nëse ka lindur arsyeja për ndërprerje apo shkarkim nga funksioni të gjyqtarit kushtetues, këtë e vërteton vetë GJKMZi dhe njofton Kuvendin e Malit të Zi për një gjë të tillë (parag. 3). GJKMZi mund të vendos që kryetari ose gjyqtari kushtetues kundër të cilëve ka filluar procedura penale, mos të ushtrojnë funksionin e tyre deri sa zgjat procedura e tillë (parag. 4).

31. Gjykata Kushtetuese e Serbisë

Gjyqësia kushtetuese në Serbi është futur në kohë të njëjtë si në republikat tjera ish-jugosllave, në vitin 1963, ka filluar me punë në vitin 1964, njëjtë si gjykatat tjera kushtetuese republikane, dhe ka ndjekur rrugë të njëjtë zhvillimi me gjyqësinë kushtetuese të ish-Jugosllavisë. Edhe në nivel të njësive federale, gjyqësitë kushtetuese kanë qenë thuajse të njëjta dhe nuk kanë pasur ndonjë dallim mes veti. Modeli i kësaj gjyqësie ka qenë, qartë shihet, evropiano-kelenian, me organin e gjyqësisë kushtetuese të ndarë nga gjyqësori rregullt dhe me juridiksion të qartë të kontrollit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Kjo përbënte një risi për një vend komunist, kur epërsia e kuvendeve dhe ligjit nën direktivat e partisë komuniste përfaqësonte standardin thelbësor. Sikundër u tha më herët, funksioni primar i kësaj gjyqësie ka qenë mbrojtja dhe ruajtja e vlerave të një sistemi kushtetues, për të cilin kanë qenë të huaj ndarja dhe balancimi pushteteve, sundimi i ligjit, demokracia dhe të drejtat e minoriteteve. Serbia, njëjtë si njësitë tjera federale, ka nisur braktisjen e kësaj rruge të zhvillimit kushtetues me nxjerrjen e **KSerb** të vitit 1990, kurse me KSerb të vitit 2006, pas shkëputjes së Malit të Zi nga Bashkësia Shtetërore Serbi-Mali i Zi, përfundimisht ka krijuar një gjyqësi kushtetuese që distancohet nga rregullimi shoqëror socialist, me synim ndjekjen e përvojës së vendeve evropiane në ndarjen dhe balancimin e pushteteve dhe rolin parësor të gjyqësisë kushtetuese në sigurimin e epërsisë së kushtetutës dhe ligjit, respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve. Kjo reflektohet edhe në KSerb të vitit 2006, aktualisht në fuqi, e cila definon rolin e dyfishtë të **GJKSerb**: si mbrojtëse e Kushtetutës dhe ligjit dhe si mbrojtëse e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve (neni 166.1 i KSerb). Kjo fizionomi është zbërthyer tutje në dispozitat kushtetuese mbi juridiksionin, përbërjen dhe zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues, mandatin e tyre dhe çështje të tjera. që gjenden në dispozitat e **GJKSerb** dhe të **Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese** (LGJKSerb). Organizimi i punës, mënyra punës dhe vendimmarrjes, si dhe llojet e procedurave para GJKSerb normohen më detajisht me **Ligjin për Gjykatën Kushtetuese** (LGJKSerb), i miratuar në vitin 2007. Njëjtë si në gjykatat kushtetuese përreth Kosovës, përveç Maqedonisë së Veriut, **GJKSerb** ka rregulloren e brendshme që normon në mënyrë edhe më të detajuar aspektet e organizimit të brendshëm, punës së gjykatës dhe çështje të tjera të brendshme. Këto nuk diskutohen këtu, siç nuk janë diskutuar në asnjërën prej gjykatave kushtetuese të rajonit.

Pjesa e gjashtë e **KSerb** (nenet 166-175) flet për **GJKSerb**. Pasi normon fizionominë e **GJKSerb** në paragrafin e parë të nenit 166, në dispozitën e paragrafit të dytë të këtij neni bëhet cilësimin e vendimeve të **GJKSerb** si ”përfundimtare, të ekzekutueshme dhe të detyrueshme për të gjithë”. Nuk flet për organin që garanton zbatimin e tyre. Këtë e bën në nenin 171, ku tregon se vetë GJKSerb përcakton modalitetin e zbatimit të vendimeve të veta, kurse ligjit ia lë përcaktimin e organit që kryen zbatimin e këtyre vendimeve: **LGJKSerb** në mënyrën të qartë tregon se në rast nevoje, vendimet i **GJKSerb** i zbaton ekzekutivi, sipas modaliteteve të zbatimit që i përcakton me vendim vetë **GJKSerb** (neni 104.2 i LGJKSerb).

Neni 167 i KSerb normon kompetencën e GJKSerb, e cila është kompetente për të vendosur lidhur me sa vijon:

- pajtueshmërinë e ligjeve dhe akteve të përgjithshme me KSerb, rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare dhe marrëveshjet e raftifikuara ndërkombëtare;

- pajtueshmërinë e marrëveshjeve të ratifikuara me KSerb;
- pajtueshmërinë e akteve të tjera të përgjithshme me ligjin;
- pajtueshmërinë e statuteve dhe akteve të përgjithshme të krahinave autonome dhe njësive të vetëqeverisjes lokale me KSerb dhe ligjin;
- pajtueshmërinë akteve të përgjithshme të organizatave që kanë autorizime publike, partive politike, shoqatave të qytetarëve dhe marrëveshjeve kolektive me KSerb dhe ligjin.

Këto janë pesë pikat e paragrafit të parë të nenit 167 si më sipër. Pikat tjera të paragrafit të dytë të këtij neni normojnë kompetencat e **GJKSerb** lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për kompetencë. Para se të kalojmë aty, duhet t'i themi disa fjalë për kompetencat e çuditshme të GJKSerb sa i përket vendit dhe raportit të marrëveshjeve ndërkombëtare në rendin juridik serb. Siç u pa, KSerb me këtë nen autorizon kontrollin represiv të kushtetutshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare (pas ratifikimit të tyre). Hans Kelsen ka thënë se, shumë kohë më herët, më 1929, nuk ekzistojnë pengesa juridike që të parashikohet kontrolli kushtetues represiv i marrëveshjeve ndërkombëtare. As në të drejtën kushtetuese nuk ka një pengesë të tillë. Por, sipas tij, ka pengesa të natyrës politike që shteti duhet mirë t'i peshoj kur vendos për një hap të tillë sipas autorizimit në tekstin kushtetues që lejon organin nacional të gjyqësisë kushtetuese për ushtrim të kontrollit kushtetues represiv të marrëveshjeve ndërkombëtare. Kjo do të vënte organin nacional të gjyqësisë kushtetuese në pozitën e gjykatës ndërkombëtare, që do të vlerësonte dhe ndalonte detyrimet ndërkombëtare të shtetit të cilit i takon, duke vlerësuar edhe sjelljet dhe veprimet e shteteve ose organizatave të tjera palë në marrëveshjet e tilla ndërkombëtare të vlerësuara në nivelin nacional.[344] Në **Evropë**, për momentin, ekzistojnë tri lloje të sistemeve juridiko-kushtetuese që përcaktojnë vendin dhe rolin e traktateve ndërkombëtare në sistemin e brendshëm. Në disa shtete, kushtetutat nacionale u japin një status special, në veçanti kur flitet për traktatet nga fusha e të drejtave të njeriut;[345] në disa të tjera, traktatet kanë statusin ndërmjet kushtetutës dhe ligjit;[346] dhe, së fundi, në disa vende evropiane, traktatet e të gjitha llojeve, me kushtetutë nacionale, gëzojnë statusin e ligjit të zakonshëm.[347] Këtu bën përjashtim Holanda, e cila i jep një primat absolut të drejtës ndërkombëtare, pa marrë parasysh burimin e saj (traktat, zakon ndërkombëtar apo burim tjetër i të drejtës ndërkombëtare). Vlen të theksohet se Kosova bën pjesë në kategorinë e shumicës së shteteve evropiane që traktatit ndërkombëtar ia njohin fuqinë mbi ligjin e zakonshëm dhe nën dispozitat kushtetuese, me përjashtim të traktateve mbi të drejtat e njeriut të cilat kanë fuqinë e normës kushtetuese si çdo normë tjetër kushtetuese.

344 Cf. më shumë për Hans Kelsen, si dhe për zbatimin e parimit të proporcionalitetit dhe shtjellimet tjera të tij në mes të dy luftërave botërore, në disertacionin e pabotuar të doktoratës të Olivera Vucic, *Austrijsko ustavno sudstvo – čuvar federacije i ustava* (mbrojtur më 1995 në Fakultetin Juridik në Universitetin e Beogradit), fq. 200-204.

345 Kjo është kështu me shumicën e shteteve të ish-lindjes komuniste ku traktatet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut kanë status të privilegjuar në sistemin e tyre juridiko-kushtetues, duke qëndruar mbi ligjet e zakonshme, në disa raste edhe baras me vetë kushtetutat nacionale (p.sh., Shqipëria dhe Maqedonia Veriut). Ky trend I ndërkombëtarizimit ka filluar pas mbarimit të **Luftës së Ftohtë**. Cf. më shumë në materialet si vijon: Eric Stein, "International Law in Internal Law: Towards Internationalisation of Central – Estern European Constitutions". *American Journal of International Law* Vol. 88 No. 3 (July 1994) fq. 427-450; European Commission for Democracy Through Law (Vennice Commission), "The Relationship Between International and Domestic Law". *Science and Technique of Democracy* No. 5. CDL – STD (1995) 005 (Strasburg, 15 September 1993), në veçanti seksioni: *The Implementation of International Human Rights Agreements*.

346 Ky është standardi i pranuar nga shumica e vendeve evropiane, pa llogaritur këtu traktatet mbi të drejtat e njeriut. Kjo do të thotë se, në shumicën e vendeve evropiane, traktatet ndërkombëtare të ratifikuara nga parlamenti bëhen pjesë e sistemit të brendshëm pas publikimit të tyre në një gazetë zyrtare dhe mund të zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke pasur kështu fuqinë mbi ligjin e zakonshëm që rri sipas fuqisë juridike menjëherë pas dispozitave kushtetuese. Cf. Thomas Burgenthal, "Modern Constitutions and Human Rights Treaties". *Columbia Journal of Transnational Law* Vol. 36 (Special Double Issue) 1997, fq. 211-223; European Commission for Democracy Through Law (Vennice Commission), "The Relationship Between International and Domestic Law", ne veçanti seksioni: *The Elaboration of Model Clauses on the Relationship Between International and Domestic Law*.

347 Në **Britaninë e Madhe** dhe në vendet e tjera të modeluara sipas saj, nuk bëhet ndonjë dallim ndërmjet traktateve ndërkombëtare të përgjithshme dhe atyre mbi të drejtat e njeriut, sepse dy llojet e traktateve në fjalë kanë statusin e ligjit të zakonshëm britanik. Cf. më shumë te Anthony Aust, *Modern Treaty Law in Practice* (Cambridge University Press: Cambridge, 2000) fq. 151-154.

Të kthehemi tani në pjesën e dytë të nenit të njëjtë të KSerb, që përcakton se GJKSerb:

- zgjidh konfliktin për kompetencë mes gjyqeve dhe organeve të tjera shtetërore;
- zgjidh konfliktin për kompetencë mes organeve republikane dhe organeve krahinore ose organeve të njësive të vetëqeverisjes lokale;
- zgjidh konfliktin për kompetencë mes organeve krahinore të pushtetit dhe organeve të njësive të vetëqeverisjes lokale;
- zgjidh konfliktin për kompetencë mes organave të krahinave të ndryshme autonome ose njësive të ndryshme të vetëqeverisjes lokale;
- vendos për kontestet zgjedhore për të cilat me ligj nuk është përcaktuar kompetenca e gjyqeve;
- kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me KSerb dhe ligj.

Në paragrafin e parafundit të nenit 167 të KSerb përcaktohet e drejta e GJKSerb për të vendosur për ndalimin e punës së partisë politike, organizatës sindikale ose shoqatës së qytetarëve. Në paragrafin e fundit, ndërkaq, normohet kompetenca reziduale e GJKSerb: ajo kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me KSerb. Siç shihet nga kjo pjesë e këtij neni, GJKSerb ka kompetenca fiktive për zgjedhjen e konfliktit për kompetencë ku si palë paraqiten organet e pushtetit në autonomitë politiko-territoriale serbe, ku hyn edhe Kosova (krahas Vojvodinës). Një cilësi tjetër e këtyre kompetencave është se shumë ngjasojnë me zgjidhjet kushtetuese malazeze, siç mund të shihet nga shtjellimet tona si më sipër.

Në nenet 168-171, **KSerb** rregullon çështjen lidhur me vendimmarrjen, subjektet e autorizuara për të vënë në lëvizje procedurën dhe llojet e mbrojtjes kushtetuese përmes mekanizmit të gjyqësisë kushtetuese. Neni 168, në pesë paragrafë, përmbledhë parimet bazë mbi vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Në paragrafin e parë tregon se procedurën për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë mund ta vejë në lëvizje organet shtetërore, organet e autonomive territoriale ose të vetëqeverisjes lokale, si dhe më së paku 25 deputetë të Kuvendit të Serbisë. Procedurën mund ta vejë në lëvizje edhe vetë GJKSerb, **sua sponte**, një autorizim ky tipik i organit kushtetues në vendet ish-jugosllave. Për fillimin e procedurës me vetëiniciativë, kërkohen votat e dy të tretave të gjithë gjyqtarëve (neni 50.2 i **LGJKSerb**).

Njëjtë si në rastin malazez, në paragrafin e dytë të nenit 168 të KSerb normohet e drejta e çdo personi fizik dhe juridik për ndërmarrjen e iniciativës për vënien në lëvizje të procedurës për vlerësim të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Fuqia juridike e ligjit ose aktit tjetër të përgjithshëm që nuk është në pajtim me **KSerb** pushon ditën e publikimit të vendimit të GJKSerb në gazetën zyrtare, thuhet në paragrafin e tretë të këtij neni. Definimi efekteve juridike të vendimit të mbi **masën e përkohshme** të **GJKSerb** rregullohet me paragrafin në vijim, i cili thotë se "deri në marrjen e vendimit përfundimtar dhe nën kushtet e përcaktuara me ligj, Gjykata Kushtetuese mund të ndaloj ekzekutimin e aktit individual apo ndërmarrjen e veprimit të bazuar në ligj ose akt tjetër të përgjithshëm, kushtetutshmëria dhe ligjshmëria e të cilave është duke u vlerësuar". Sipas **LGJKSerb**, arsyet për vënien e **masës së përkohshme**, përkatësisht për ndalimin e ekzekutimit të aktit individual apo ndërmarrjen e veprimit të bazuar në ligj ose akt tjetër të përgjithshëm, kushtetutshmëria dhe ligjshmëria e të cilave është duke u vlerësuar ka të bëj me pengimin e shkaktimit të dëmeve të pariparueshme (neni 56.1). Së fundi, në paragrafin e katërt të nenit 168 të KSerb gjendet një dispozitë shumë e rëndësishme dhe e rrallë për kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, që ndikon pozitivisht në sigurinë juridike të qytetarëve. Bëhet fjalë për autorizimin dhënë GJKSer për të bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së kateve juridike që më nuk janë në fuqi, që ka pushuar fuqia e tyre juridike. Në një rast të tillë, **GJKSerb** mund të ushtroj kontrollin e pajtueshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjera të përgjithshme me KSerb, pajtueshmërinë e akteve të përgjithshme me ligjin edhe pasi të kenë pushuar së vlejturi, nëse procedura e tillë ka filluar më së voni brenda gjashtë muajve nga dita e ndërprerjes së fuqisë së tyre juridike. Neni 169 i **KSerb** i kushtohet **kontrollit preventiv të kushtetutshmërisë** së ligjit. Me kërkesën e së paku të dy të tretave të deputetëve, GJKSerb ka autorizim që, brenda shtatë ditëve, të vlerësoj kushtetutshmërinë

e ligjit që është miratuar (votuar) në Kuvendin e Serbisë (parag.1). Nëse ligji shpallet para vendimit mbi kushtetutshmërinë, **GJKSerb** do të vazhdoj, sipas kërkesës, me procedurën e nisur për vlerësimin e kushtetutshmërisë, në pajtim me procedurën e rregullt që vlen për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit (parag. 2). Nëse **GJKSerb** merr vendim para shpalljes së ligjit, atëherë vendimi hyn në fuqi ditën e shpalljes së ligjit (parag. 3). Procedura për vlerësim të kushtetutshmërisë nuk mund të filloj kundër ligjit kushtetutshmëria e të cilit është konstatuar para hyrjes së tij në fuqi (parag. 4).

Neni 170 i **KSerb** normon, në vetëm një paragraf, **ankesën kushtetuese**. Ajo mund të parashtrohet kundër vendimeve individuale ose veprimeve të organeve shtetërore ose organizatave që ushtrojnë autorizime publike, me të cilat shkelen ose cungohen liritë dhe të drejtat njerëzore ose të minoriteteve të garantuara me KSerb, pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e tyre ose nuk ekzistojnë mjete të tilla juridike.

Neni 171 i **KSerb**, siç u tha, normon çështjen e ekzekutimit të vendimeve të GJSerb, siç u diskutua më sipër. Ky nen pasohet nga neni 172, që normon përbërjen si dhe zgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve të **GJKSerb**. Këtë e bën në shtatë paragrafë. I pari paragraf përcakton se GJKSerb përbëhet nga 15 gjyqtarë, që zgjidhen dhe emërohen për mandat nëntëvjeçar. Pesë nga gjyqtarët kushtetues serbë zgjidhen nga **Kuvendi i Serbisë**, pesë emërohen nga Presidenti Republikës, kurse pesë nga mbledhja e përgjithshme e **GJSKSerb** (parag. 2). Kuvendi zgjedh pesë kandidatët në mesin e kandidatëve të propozuar nga Presidenti i Republikës, Presidenti i Republikës emëron pesë gjyqtarët kushtetues nga mesi dhjetë kandidatëve që propozohen nga Kuvendi i Republikës, kurse mbledhja e përgjithshme e **GJSKSerb** emëron pesë gjyqtarë nga mesi dhjetë kandidatëve që në mbledhjen e përgjithshme i propozojnë **KLGJSerb** dhe **KSHPSerb** (parag. 3). Nga secila listë e kandidatëve të propozuar, njëri nga kandidatët e zgjedhur duhet të jetë nga territori i krahinave autonome (parag.4). Gjyqtarët kushtetues zgjidhen dhe emërohen nga mesi i juristëve të dalluar me moshë së paku dyzetvjeçare dhe përvojë juridike prej pesëmbëdhjetë viteve (parag. 5). I njëjti person mund të zgjidhet ose emërohet për gjyqtarë kushtetues më së shumti dy herë (parag. 6). Gjyqtarët kushtetues, nga përbërja e tyre zgjedhin kryetarin me mandat trevjeçar (parag. 7). Neni 173 i KSerb, në dy paragrafë, rregullon çështjen e konfliktit të interesit dhe imunitetin. Gjyqtari kushtetues nuk mund të ushtroj asnjë funksion tjetër publik ose profesional dhe as punë tjetër, përveç profesurës në fakultete juridike në Republikën e Serbisë, në pajtim me ligjin (parag. 1). Sipas nenit 16 të **LGJKSerb**, nuk konsiderohet konflikt interesi puna kulturore-artistike, sportive, humanitare dhe tjetër, që bëhet pa pagesë. Si punë e profesorit ndërkombëtar, ndërkaq, sipas këtij ligji, konsiderohet vetëm ajo që kryhet në nivel të profesorit ordinar dhe inordinar, që janë të barasvlefshëm me profesor i asocuar dhe profesor i rregullt. Kjo nënkupton se asistentët dhe profesorët asistent nuk mund të jenë gjyqtarë kushtetues.

Neni i parafundit, neni 174 i **KSerb** normon **ndërprerjen e funksionit të gjqytarit kushtetues**.
Detyra e gjyqtarit kushtetues ndërpritet me kalimin e kohës për të cilën është zgjedhur, përkatësisht emëruar, me kërkesën e gjyqtarit kushtetues, kur përmbush kushtet e kërkuara ligjore për pension të pleqërisë ose me shkarkim (parag.1). Gjyqtari kushtetues shkarkohet nëse cenon rregullin mbi konfliktin e interesat (papajtueshmëria), përherë humb aftësinë e veprimit për të ushtruar funksionin e gjyqtarit kushtetues, dënohet për vepër penale me dënim me burg ose për vepër penale, e cila e bën të padenjë për të ushtruar detyrën e gjyqtarit të **GJKSerb**. Mbi ndërprerjen e detyrës së gjyqtarit kushtetues, me kërkesë të propozuesve të autorizuar për zgjedhje përkatësisht emërim të gjyqtarit të GJKSerb, vendos Kuvendi i Serbisë. Iniciativën për fillim të procedurës për shkarkim mund ta parashtroj GJKSerb. Së fundi, neni 175 i **KSerb** flet për mënyrën e vendimmarrjes në **GJKSerb** dhe **LGJKSerb**. Vendimet në GJKSerb merren me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve kushtetues (parag. 1). Vendimin për fillimin sua sponte të procedurës, siç u tha, GJKSerb e merr me shumicën prej dy të tretave të të gjithë gjyqtarëve të saj (parag. 2). Rregullimi i brendshëm i **GJKSerb**, procedura dhe efekti juridik i vendimeve të saj rregullohen me **LGJKSerb**.

32. Ushtria dhe policia

32.1. Kuptimi dhe format e ushtrisë

Me ushtri nënkuptohet tërësia e forcave të armatosura (forcës ushtarake) të një shteti. Ushtria është, në njërën anë, faktor autonom dhe i dallueshëm në shtet dhe, në anën tjetër, ajo është organ shtetëror që, si i tillë, bën pjesë të pandashme të aparatit shtetëror. Shkaku kryesor për ekzistimin e ushtrisë dhe arsyeja kryesore pse qytetarët duhet të shërbejnë në ushtri ka të bëj çdo herë me nevojën e domosdoshme për mbrojtjen e shtetit. Kjo nevojë e domosdoshme tërheq me vete detyrimin ushtarak të qytetarëve të një shteti, edhe atëherë kur ajo shoqërohet me rrezikun për jetë. Përveç përgatitjes për pengimin e okupimit dhe agresionit ndaj territorit shtetëror, funksioni i ushtrisë konsiston edhe në veprimin preventiv, si mjet për pengimin e agresorit, ku ushtria, në të njëjtën kohë, kontribuon në zvogëlimin e rrezikut nga cenimi sigurisë së vendit. Ushtria, pra, kryen njërin ndër funksionet kryesore të një vendi – funksionin mbrojtës, funksionin e mbrojtjes së kufijve të jashtëm të shtetit. Ky funksion themelor i ushtrisë – mbrojtja e vendit nga agresioni jashtëm – në aspektin **juridik-kushtetues** shprehet përmes fjalisë: funksioni mbrojtjes së **sovranitetit dhe integritetit territorial** të shtetit. Krahas këtij funksioni, ushtrisë i jepet apo njihet, normativisht ose faktikisht, edhe një funksion i brendshëm që njihet si **funksioni i ruajtjes së rendit kushtetues**.

Sot ekzistojnë tri sisteme të plotësimit të radhëve të ushtrisë dhe organizimit të saj. I pari është sistemi **ushtrisë profesionale** që bazohet në personel në përbërje të përhershme dhe vullnetarë të paguar që shërbejnë për një periudhë të caktuar. Sistemi i dytë ai **ushtrisë me rekrutim**, bazuar në shërbimin e detyrueshëm ushtarak, me një numër të madh ose të vogël të vullnetarëve të paguar, gjë që karakterizon edhe sistemin e kombinuar të plotësimit të radhëve të ushtrisë. Sistemi tretë është **organizimi policor** i i organizimit ushtarak. Forma e parë e ushtrisë ekziston në SHBA, Britani, Kanada etj. Fillimisht ka lindur në Angli si shprehje e nevojave koloniale të shtetit për ushtri profesionale. Forma e dytë e ushtrisë praktikisht është kombinim i përbërjes profesionale dhe asaj rekrut të ushtrisë. Te kjo formë e ushtrisë, madhësia e kontigjentit profesional permanent (ushtar dhe oficer me kontratë) varet nga mundësitë materiale të vendit, që nënkupton, për pasojë, se nga të njëjtat kushte varet edhe madhësia e ushtrisë së vendit. Kjo formë e ushtrisë përdoret më së shumti në vendet evropiane, përfshirë disa vende fqinje me Kosovën, si Serbia. Forma e tretë e ushtrisë është zbatuar në Austri, Izrael, Suedi dhe Zvicër. Kjo bazohet në forcën e armatosur të popullit, e cila aktivizohet vetëm në rast të luftës. Në kushtet e paqes ekziston vetëm baza kadrovike (e personelit profesional - oficerët) dhe trajnimet e kohëpaskohshme të përbërjes rezervë. Për ushtrinë policore, karakteristikë e saj është se ajo nuk ka gatishmëri operative në kohë paqeje, të cilën e fiton (e merr) vetëm pas mobilizimit të kryer.

Në kohën e sotme, për shkak të komplikueshmërisë së sistemeve luftarake, përdorimi i të cilave kërkon ndarje të punës dhe specializim të lartë teknik, është vënë në pikëpyetje ekzistimi i ushtrime masive që bazohet në rekrutimin e përgjithshëm (detyrimin e përgjithshëm ushtarak), siç ka qenë në të kaluarën. Me teknikën dhe mjetet bashkëkohore luftarake mund të operojnë personeli i specializuar dhe profesional, është iluzore të pritet që ato të përdoren nga secili qytetar. Edhe sikur të ishte e mundur, një gjë e tillë do të ishte shumë e shtrenjtë edhe për vendet më të zhvilluara. Përveç kësaj, në përmasa ndërkombëtare pranohet gjerësisht se ndalohet përdorimi forcës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe tejkalimin e kundërthënieve ndërkombëtare. Krejt këto përbëjnë arsye pse sot ushtria masive nuk konsiderohet simbol i pakontestueshëm i sovranitetit nacional. Zgjidhjet, për këtë shkak, kërkohen në zvogëlimin dhe profesionalizimin (të tërësishme ose pjesërisht) e ushtrisë përmes futjes së formës së ushtrisë profesionale ose të kombinuar (rekruto-profesional). Në kushte të tilla, kur profesionalizimi i tërësishëm ose i pjesshëm i ushtrisë është një nevojë e domosdoshme, në plan të parë del çështja e kontrollit efikas dhe epërsia e organeve civile ndaj atyre ushtarake.

32.2. Parimet e organizimit dhe pozita e ushtrisë në rendin demokratik

Parimi **hierarkisë**, **komandimit të centralizuar** dhe **dëgjueshmërisë pa kundërshtim** përfaqëson **rregullin themelor** sipas të cilit ushtria organizohet dhe funksionon. Nga kjo rregullon buron edhe detyrimi për zbatim të urdhrit. Ky parim, si i tillë, është pasojë e funksionit themelor të ushtrisë dhe thelbit të profesionit ushtarak, i cili kërkon kundërvënien kundërshtarit në luftë sa më shpejt dhe me sukses. Për këtë arsye ushtria duhet të jetë një organizatë shoqërore kompakte dhe të bazohet në dëgjueshmërinë pa kundërshtime dhe pa kushte. Nën ndikimin e krimeve të luftës, kundër njerëzimit dhe gjenocidit, të kryera gjatë **Luftës së Dytë Botërore**, ka ardhur deri te relativizimi i parimit të dëgjueshmërisë pa kundërshtime dhe pa kushte, ashtu që sot, kur është fjala për rendin ndërkombëtar, me këtë parim nënkuptohet kryerja e të gjitha detyrimeve ushtarake, përveç atyre që janë kriminale në shikim të parë. I lidhur ngushtë me sistemin e komandimit është edhe parimi i profesionalizmit të oficerëve dhe botëkuptimit sipas së cilit ushtria është organizatë shoqërore profesionale.

Profesionalizmi bëhet parim i rëndësishëm i organizimit ushtarak në **Prusi** në fillim të shek. XIX, kur nga eprorët ushtarakë kërkohet pasja e një aftësie të posaçme ushtarake që fitohet me shkollim formal ushtarak. Kjo ishte e natyrshme meqë në Prusi kishte shekuj që ushtria e përhershme, **miles perpetuus**, kishte zënë rrënjë dhe ishte bërë faktor i prosperitetit dhe progresit të kombit gjerman deri në unifikimin e tij.[348] Përvoja të njëjta me krijimin e ushtrisë profesionale i hasim edhe në kohën e Napolonit, me dekretin e datës 24 shtator 1803 mbi rioragnizimin e regjimenteve dhe kuadrin e përgjithshëm të ushtrisë perandorake.[349] Sot me profesionalizmin e shërbimit ushtarak nënkuptohen gjërat si vijon: 1. eprorët ushtarak edukohen formalisht për shërbimin ushtarak; 2. shekullin e tyre të punës e kalojnë në ushtri, deri në pension, dhe mund të shkarkohen nga detyrat e tyre vetëm sipas kushteve të paracaktuara më parë me norma juridike (humbja e aftësisë për të shërbyer në ushtri, kryerja e veprës penale etj.); përparimi apo gradimi në ushtri kryhet sipas rregullave të paracaktuara, kushteve të matshme dhe të drejta për të gjithë; 4. Që detyrimi i tyre ndaj shteti shprehet në nënshtrimin ndaj organeve zyrtare shtetërore, jo ndaj ndonjë subjekti apo aktori tjetër joshtetëror (siç janë, ta zëmë, partitë politike ose pushteti lokal); 5. financimin e tyre e siguron shteti, përmes sistemit të rregullt të rrogave dhe, nën kushtet e përcaktuara me kushtetutë e ligj, u takojnë edhe pensionet ushtarake.

Nga parimet e sipërcekura rrjedh edhe **parimi i depolitizimit** të ushtrisë. Ushtria është organ shtetëror, i cili në sistemin e organeve shtetërore ka vendin dhe përgjegjësinë e vet. Detyrimet e saj janë vetëm ndaj shtetit, që nënkupton se ajo duhet të jetë politikisht neutrale ndaj politikës dhe njerëzve në funksione politike. Ekzsiton një thënie lidhur me këtë: derisa politikanët bërtasin, ushtria hesht! Në traditën franceze kjo thënie për ushtrinë shprehet me thënien tjetër të njohur, sipas së cilës ushtria është **heshtaku i madh** ("la grande muette").[350] Version drastik i kësaj praktike është privimi i anëtarëve të ushtrisë nga të drejtat aktive dhe pasive zgjedhore. Depolitizimi i ushtrisë, megjithatë, nuk nënkupton që pjesëtarët e saj duhet të zhvishen nga njohuritë politike dhe mbi politikën. Përkundrazi, profesionistët ushtarakë duhet të kenë edhe njohuri politike, që të kuptojnë natyrën e ushtrisë si organizatë shoqërore dhe ambientin politik e shoqëror në të cilin ushtria jeton dhe vepron. Pa njohuritë nga shkencat politike nuk mund të bëhet vlerësimi i situatës së politiko-ushtarake dhe të sigurisë brenda së cilës veprohet ushtarakisht ose parashikohet të veprohet ushtarakisht në të ardhmen. Profesionisti ushtarak duhet ta njoh sistemin kushtetues të shtetit dhe mënyrën e funksionimit të tij, si dhe pozitën kushtetuese të ushtrisë në atë sistem. Në këtë sferë nuk ka

---

348 Rrënjët e vërteta të ushtrisë permanente prusiane duhen kërkuar dhe gjetur në **Luftën e Veriut** me Suedinë (1655-1660), por që ngjizja e ushtrisë në fjalë daton nga lufta tridhjetëvjeçare dhe **Paqja Vestaflisë** (1648). Cf. më shumë në Sidney B. Fay, "The Beginnings of the Standing Army in Prussia". *The American Historical Review* Vol. 22 No 4 (July 1917), fq. 763- 777; Dierk Waiter, "A Military Revolution? Prussian Military Reforms before the Wars of German". Unification *FORSVARSSTUDIER* 2/2001, Oslo), fq. 4-34.

349 Cf. më shum në François Houdecek, "Training and Teaching of Conscripts During the Boulogne Camp". *Napoleonica La Revue* Vol. 32 No 2 (2018), fq. 86-96.

350 Cf. më shumë në Hans STARK L'armée: grande muette ou grande inconnue? *Politique étrangère* Vol. 55, No. 4 (HIVER 1990), fq. 813-822.

edhe nuk mund të ketë neutralitet. Politizimi i tillë, nëse mund të quhet cilësohet kështu fitimi i njohurive politike, është pjesë përbërëse e profesionalizimit të profesionit ushtarak. Në bazë të kësaj që u tha deri këtu, mund të arrijmë në përfundimin se depolitizimi i ushtrisë nënkupton ekzistimin e parametrave matës për vlerësimin nëse ka ndodhur një gjë e tillë. Kjo nënkupton se, për të vlerësuar një gjë të tillë, duhet të ketë një përcaktim dhe respektimi i masave sa vijon: 1. Ndalimi i punës së partive politike në ushtri; 2. Ndalimi i anëtarësimit të kuadrit ushtarak në parti politike; përjashtimi i eprorëve ushtarakë (pjesëtarëve të ushtrisë) nga vendimmarrja politike.

Parimi i nënshtrimit të ushtrisë ndaj autoriteteve të pushtetit civil është vija ndarëse themelore e pozitës së ushtrisë në rendet demokratike. Marrëdhënia e kundërt, ku nuk ka kontroll civil ndaj ushtrisë ose kur ai kontroll nuk është efektiv, cilësohet si **pretorianizëm**.[351] **Kontrolli civil ndaj ushtrisë ekziston vetëm atëherë kur trupa ushtarake e oficerëve, eprorëve, në tërësi i nënshtrohet organit civil shtetëror.** Ky nënshtrim shprehet ashtu që për përdorimin e forcës së armatosur vendos shteti përmes organeve civile. Qëllimet politike dhe synimet globale lidhur me ushtrinë i përcakton shteti, në ndërkohë që kuadri udhëheqës ushtarak merret me çështjet që lidhen me profesionin e ushtrisë. Ky parim është një ndër garancitë dhe parakushti themelor për ekzistimin e një rendi politik demokratik. Fakti që funksioni i ushtrisë është mbrojtja e shtetit mund të prodhojë ndjenjën te ushtria se, vetëm ajo dhe askush tjetër, ka të drejtën e definimit të interesit shtetëror. Kjo ndjenjë dhe pikëpamje mund të çoj në situatat ekstreme të uzurpimit të institucioneve politike nga ana e ushtrisë, me çka rrënohen themelet kushtetuese të sistemit demokratik politik të shtetit.

Në teori është theksuar se arsyeja e dëgjueshmërisë së ushtrisë nuk është fizike, po psikologjike. Kur flitet për vëllimin e forcës fizike, ushtria gjendet në përparësi absolute në raport me organet civile, sepse ajo çdo herë mund të vej nën kontroll civilët e paarmatosur. Në secilin shtet, ushtria posedon me teknikë dhe mjetet më të rrezikshme, përdorimi i të cilave ose kërcënimi me përdorimin e tyre mund të çoj në ndryshimin e karakterit dhe rrjedhës së proceseve dhe marrëdhënieve politike. Arsyeja kryesore pse ushtria, përkundër kësaj force fizike, i nënshtrohet autoriteteve dhe organeve civile qëndron në **kulturën politike dominante** të një shoqërie. Kjo kulturë politike përcakton qëndrimin e ushtrisë ndaj vetvetes dhe të popullit ndaj saj.

Dy **format kryesore të nënshtrimit të ushtrisë ndaj organeve dhe autoriteteve civile** janë pasojë e zbatimit të sistemeve të ndryshme të pushtetit ose të sistemeve të ndryshme të organizimit të pushtetit ekzekutiv. Sipas të parit, ushtria i nënshtrohet **parlamentit** kurse sipas të dytit ajo i nënshtrohet **shefit të shtetit**. Në sistemin e parë, kontrollin e ushtrisë dhe marrjen e vendimeve politike lidhur me organizimin ushtarak dhe përparimin e kuadrit ushtarak e kryen parlamenti përmes qeverisë që del nga shumica parlamentare. Ta zëmë, në **Britani të Madhe**, **Gjermani**, **Indi**, **Itali**, **Izrael**, me ushtrinë udhëheq kancelari, përkatësisht kryetari i qeverisë përmes ministrit të mbrojtjes. Sipas sistemit të dytë, që është më i përhapur se i pari, funksionin e komandantit suprem të forcave të armatosura e ushtron shefi i shtetit, kurse parlamenti ka kontroll ndaj buxhetit ushtarak. Përkundër institucionalizimit të parimit të nënshtrimit të ushtrisë ndaj autoriteteve dhe organeve civile zyrtare, përgjatë shekullit XX kjo ka qenë përjashtim më shumë sesa rregull. Vetëm një numër i vogël i demokracive stabile të vendeve më të fuqishme ekonomike në Evropë dhe Amerikë Veriore, nuk kanë përjetuar gjatë shek. XX padëgjueshmëri dhe rebelim të ushtrisë kundër autoriteteve kushtetuese civile. Tendenca për uzurpim të pushtetit civile nga ana e ushtrisë ka qenë e shprehur në veçanti në demokracitë e brishta dhe në shtetet e pazhvilluara. Në **Azi** ka pasur periudha kur kanë ekzistuar më shumë se një e treta e regjimeve ushtarake, kurse në **Amerikë Latine** më shumë se dy të tretat. Krahas kësaj, gjatë kohës së Luftës së Ftohtë, në **vendet në**

[351] Amos Perlmutter, "The Praetorian State and the Praetorian Army: Toward a Taxonomy of Civil-Military Relations in Developing Polities". *Comparative Politics* Vol. 1, No. 3 (April 1969), fq. 382-404; Ky term përdoret edhe për rrëzimin e pushteteve civile kushtetuese përmes rrugës, protestave massive dhe populiste, por me një emër tjetër – **pretorianizëm civil**. Cf. më shumë për këtë në kontesktin e historisë politike dhe kushtetuese të vendeve të **Amerikës Latine** në David Pion-Berlin and Harold Trinkunas, "Civilian Praetorianism and Military Shirking During Constitutional Crises in Latin America". *Comparative Politics* Vol. 42, No. 4 (July 2010), fq. 395-411.

zhvillim grushtshtetet kanë qenë bërë një dukuri e zakonshme, duke marrë (uzurpuar) kësisoj funksionet që u takojnë zgjedhjeve dhe instrumenteve të tjera demokratike për ndryshim të bartësve të pushtetit. Si shembuj tipik të kësaj gjendje janë Bolivia, Peru, Siria dhe Iraku, në të cilat gjatë kohës së **Luftës së Ftohtë** kanë ndodhur me qindra grushtshtete, disa me sukses e disa jo, me ndihmën e ushtrisë.[352] Gjendja nuk paraqitet më ndryshe as në **Afrikë**, në periudhën e njëjtë kohore.[353]

32.3. Ushtria si institucion kushtetues

Ushtria tradicionalisht është materie kushtetuese, që rregullohet me norma kushtetuese. Si ligje themelore, kushtetuta që nga paraqitja e tyre në skenë në fund të shek. XVIII, kanë ngjizur traditën e futjes së disa qëndrimeve dhe dispozitave në lidhje me mbrojtjen, ose me interes për mbrojtjen, si dhe në lidhje me pozitën e forcave të armatosura. Dallimet mes kushtetutave në këtë drejtim kanë të bëjnë më shumë me numrin e dispozitave që i kushtohen materies së ushtrisë si dhe me përmbajtjen e zgjidhjeve të përqafuara kushtetuese. Janë përjashtim vendet kushtetutat e të cilave nuk përmbajnë dispozita për mbrojtjen dhe ushtrinë. Si rast i tillë, në literaturë përmendet **Libani**.[354] Shumica më e madhe, saktësisht gati të gjitha kushtetutat në periudhat e mëparshme, e edhe kushtetutat bashkëkohore, përmbajnë ca dispozita të cilat ua kushtojnë këtyre çështjeve (mbrojtjes dhe ushtrisë). Zakonisht, këtyre çështjeve kushtetutat nuk ua kushtojnë ndonjë kaptinë ose pjesë. Ka përjashtim nga kjo rregull, megjithatë: ta zëmë, kushtetutat e **Egjiptit** (1959 dhe 2014, kjo e dyta në fuqi aktualisht), **Holandës** (1814, me amendamentet e vitit 2008; aktualisht në fuqi është Kushtetuta e vitit 2018, tërësisht e rishikuar) dhe **Ganës** (1992) i kushtojnë ushtrisë kapituj (kre) të tërë, kurse kushtetutat e **Beligjikës** (1831, me amendamentet e vitit 2014), **Finlandës** (1999, me amendamentet vitit 2011), **Jordanisë** (1952 me amendamentet e vitit 2011), **Libisë** (1951, sot në fuqi është Kushtetuta e vitit 2011), **Portugalisë** (1933) dispozitat në lidhje me ushtrinë i kanë grumbulluar në kaptina të ndryshëm të ndonjë kreu.

Kjo ndarje e kushtetutave për kah mënyra e grupimit të dispozitave mbi mbrojtjen dhe ushtrinë nuk ka rëndësi thjeshtë formale. Në **Kushtetutën e Ganës**, e cila përmban kapituj (kre) të tërë,ushtrisë i janë kushtuar vetëm dy nene, ndërsa në kushtetutat e Belgjikës dhe Jordanisë kaptinat në lidhje me armatën përmbajtën 13 Belgjika, respektivisht 9 nene. Njëkohësisht ka pasur, dhe sot ka, kushtetuta, të cilat, në lidhje me ushtrinë flasin në disa vende dhe, për atë arsye, i kushtojnë më shumë vend dhe dispozita se kushtetutat, të cilat formalisht e theksojnë më tepër. **Kushtetuta e Vajmarit** (1919) ka përmbajtur 10 nene, ndërsa **Ligji Themelor i Gjermanisë** (LTH) i vitit 1949 - 12 nene. Është karakteristike të ceket se kushtetutat e dy shteteve zyrtarisht neutrale, dikur kanë përmbajtur numrin më të madh të dispozitave në lidhje me ushtrinë. E kemi fjalën për **Kushtetutën e Zvicrës** (1874), me 17 nene, dhe **Kushtetutën e Suedisë** (1974, me amendamentet e vitit 2012, aktualisht në fuqi), me 12 nene. Ky paradoks formal sqarohet me faktin se këto janë kushtetuta të vjetra që janë nxjerr në periudhën e historisë evropiane, kur **Zvicra** dhe **Suedia** kanë qenë të njohura për ushtritë e tyre të fuqishme. Nga tërë kjo që u tha del se, ndarja ose të dalluarit e kushtetutave sipas numrit të dispozitave dhe mënyrës së të rregullatorit formal të mbrojtjes dhe ushtrisë flet tepër pak mbi rëndësinë dhe karakterin e atyre dispozitave, pra edhe mbi pozitën e ushtrisë dhe raportin e pushtetit civil me armatën.

Dy aspekte që më së shpeshti janë normuar me kushtetutë nga kjo materie kushtetuese kanë të bëjnë me të **drejtat dhe detyrat e qytetarëve ndaj mbrojtjes së vendit** dhe **marrëdhënia e ushtrisë me autoritetet e pushtetit civil**. Numri më i madh i kushtetutave, të nxjerra gjatë shek. XIX dhe decenieve të para të shekullit në vijim, dispozitën mbi mbrojtjen e vendit sipas së cilës shtetasit kanë për detyrim

---

352 Cf. më shumë për këtë në Jerzy J. Wiatr *Political Leadership Between Democracy and Authoritarianism Comparative and Historical Perspectives* (Verlag Barbara Budrich Opladen: Berlin, Toronto, 2022), fq. 77, 80-94.

353 Thomas H. Johnson, Robert O. Slater and Pat McGowan, "Explaining African Military Coups d'Etat, 1960-1982". *American Political Science Review* Vol. 78 No. 3 (1983), fq. 622-640.

354 Jovan Gjorgjeviq, *E drejta kushtetuese*, fq. 837; Për tekstin e **Kushtetutës së Libanit**, nenet e saj 49-65, cf. *Lebanon's Constitution of 1926 with Amendments through 2004.*

kryerjen e shërbimit ushtarak, e formulonin në mënyrë tradicionale të vërtetimit kushtetues të obligimit ushtarak: shërbimi ushtarak është i përgjithshëm. Kjo formulë klasike kushtetuese, e cila njëkohësisht paraqiste një detyrim të shtetasve që shprehte formën themelore të konceptit tradicional në lidhje me mbrojtjen e vendit. Kushtetutat më të reja formulonin edhe të drejtën e shtetasve që të mbrojnë atdheun ose të marrin pjesë në mbrojtjen e tij. Kushtetutat fashiste dhe dokumentet e ngjashme kushtetuese, në pajtim me ideologjinë e tyre militariste, mistike dhe ofensive-luftarake, e shpallnin këtë detyrim si një "detyrim të hyjnueshëm" "të drejtë të patjetërsueshme", "gatishmëri të shtetasve për t'u flijuar", etj. Ekzistojnë kushtetuta që kufizojnë shërbimin ushtarak të femrës, ose nuk e parashikojnë fare, por pjesa më e madhe e tyre në shekullin që lamë pas kënaqej me dispozitën mbi detyrimin e përgjithshëm të shtetasve. Disa kushtetuta bashkëkohore pranojnë lënien anash, shmangien nga shërbimi ushtarak, për arsye religjioze (bindjet e tyre fetare nuk iu lejojnë bartjen e armëve), por që ai shërbim iu zëvendësohet me ndonjë shërbim të ngjashëm. Aty ku nuk ekziston detyrimi i përgjithshëm ushtarak, që është një veçori e vendeve demokratike bashkëkohore në të shumtën e rasteve, shërbimi ushtarak normohet me kushtetutë vetëm në parim, kurse me ligje të posaçme më pastaj rregullohet modeli i plotësimit të radhëve të ushtrisë, siç u diskutua më sipër.

Në të gjitha kushtetutat rëndësi të posaçme iu është kushtetuar edhe marrëdhënieve mes ushtrisë dhe pushtetit civil. Këto marrëdhënie, në numrin më të madh të kushtetutave të vjetra dhe bashkëkohore, janë rregulluar nëpërmjet përcaktimit të funksionit të komandantit suprem, bartësit të atij funksioni, ndërsa në disa kushtetuta edhe me anë të përcaktimit të autorizimeve dhe mënyrës së të ushtruarit të funksionit të komandantit suprem. Në të gjitha rastet kontrolli civil i ushtrisë konsiderohet si kyç dhe element definues i sistemit politik dhe kushtetues në një vend. Rëndësi të përgjithshme kushtetuese, aspak më të vogël, ka edhe çështja e të vendosurit në lidhje me luftën dhe paqen dhe të shpallurit e luftës, përveç të vendosurit mbi "gjendjen përgatitore, mobile dhe luftarake". Këto janë njëherit edhe çështje themelore të kushtetutave dhe çështje të përgjithshme të kushtetutës ndaj forcave të armatosura. Gati të gjitha kushtetutat bashkëkohore ua kushtojnë së paku një, e disa edhe më shumë, dispozita këtyre çështjeve. Të gjitha shtetet të cilat në një mënyrë shprehin formën demokratike të shtetit dhe përparësinë themelore politike të parlamentit, të drejtën e të vendosurit mbi luftën, madje shpalljen e luftës, e vënë në kompetencë ekskluzive të parlamentit. Kështu vepron **Kushtetuta e Italisë** (1947, me amendamentet e vitit 2020, aktualisht në fuqi), kushtetutat e vendeve skandinave dhe **Kushtetuta e Belgjikës**. Kjo është e drejtë e parlamentit edhe sipas **konvencioneve kushtetuese** të **Britanisë së Madhe** dhe sipas **KAm**. Në kushtetutat e tipit monarkist ose me shef të fortë të shtetit, kjo e drejtë është edhe autorizim kushtetues i shefit të shtetit (**Algjeria**, **Etiopia**, **Emiratet e Bashkuara Arabe**, **Jordania**). Disa kushtetuta të hershme, por edhe bashkëkohore, e ndajnë të vendosurit mbi luftën nga shpallja e saj, ashtu që funksionin e parë ua besojnë parlamentit kurse të dytin shefit të shtetit ose qeverisë. Disa kushtetuta parashikojnë të drejtën e shefit të shtetit që ta shpall gjendjen e luftës sipas autorizimit ose vendimit të parlamentit, ose vetëm në bazë të mendimit të parlamentit. Aktin e shpalljes së luftës si të drejtë ekskluzive të shefit të shtetit e parashikojnë kushtetutat e Danimarkës, LTH Gjermanisë, Francës, Holandës, Pakistanit, Suedisë. Në disa kushtetuta (Jordania, Turqia dhe disa vende jug-amerikane) gjendja e luftës është definuar edhe si fazë më e lartë e gjendjes së rrezikshme ose jashtëzakonshme. Për rrjedhojë, kjo përfaqëson një lloj të posaçëm të gjendjes jashtëkushtetuese dhe gjendjes kur pezullohet kushtetuta. Autorizimi për aksione të tilla, sipas vetë kushtetutës, i takon shefit të shtetit.

Në një sërë kushtetutash të nxjerra pas Luftës së Dytë Botërore hasen një sërë dispozitash që përmbajnë detyrime kushtetuese dhe deklarime politike, përmes së cilave shprehet pozita e shtetit në bashkësinë ndërkombëtare ose karakteri i politikës ndërkombëtare, ose "esenca e ushtrisë", qëndrimi ndaj Kombeve të Bashkuara, sigurisë kolektive dhe formave të tjera të lidhjeve dhe bashkimeve ndërkombëtare. Kështu, ta zëmë, Kushtetuta e Italisë mohon luftën si mjet për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare dhe përcakton që ushtria kombëtare duhet të jetë e frymëzuar me ide demokratike të republikës; LTH i Gjermanisë e kualifikon luftën si vepër penale dhe veprat e tilla i shpall si krime; Kushtetuta e Austrisë, pas shpalljes së neutralitetit të këtij vendi në vitin 1955, ka ndaluar hyrjen në lidhje ushtarake. Si shenjë të

plotësimit ët detyrimeve ndërkombëtare, disa kushtetuta pas Luftës së Dytë Botërore kanë parashikuar të shpallurit e luftës me qëllim të plotësimit të këtyre detyrimeve ndërkombëtare. Disa kushtetuta ndalojnë kapitullimin e ushtrisë, ndërsa të tjerat e shpallin tradhtinë si krimin më të madh. Kushtetuta e Finlandës parashikon përgatitjet në ushtri në gjuhën finlandeze dhe suedeze njëkohësisht. Disa kushtetuta përcaktojnë se cilat të drejta qytetarë nuk mund t'i gëzojnë ushtarët, ose parashikojnë kufizimin e atyre të drejtave. Kushtetutat e Gjermanisë naziste dhe të disa regjimeve autoritare kanë përmbajtur dispozita në lidhje me të militarizuarit e edukatës fizike dhe morale (politike), në lidhje me organizatat që edukojnë masat në frymën e prijësit. Kushtetutat fashiste këtë e kanë shpallur si parim sublim të sistemit edukativ dhe civil. **Kushtetuta e Portugalisë** e vitit 1933 dhe **Karta Spanjolle** e vitit 1938, parashikonin se shteti mbron, nxit dhe përkrah institucionet civile, të cilat edukojnë rininë në drejtim të përgatitjes së saj për detyrat patriotike dhe ushtarake.

32.4. Policia: Kuptimi dhe roli

Policia, së bashku me ushtrinë, përbëjnë esencën e shtetit si organizatë shoqërore që ka monopolin mbi dhunën fizike. Marrë parasysh faktin se policia për funksion parësor ka vënien dhe mbajtjen e rendit të brendshëm shoqëror, në kushtet e paqes, jo si ushtria që mbron shtetin në kohë lufte, policia më e afërt është me drejtësinë se me ushtrinë.

Fjala polici rrjedh nga kuptimi fillestar grek **polis** (qytet-shtet), me të cilën është nënkuptuar tërë aktiviteti shtetëror në qytet-shtetin grek, me përjashtim të ushtrisë dhe gjyqësisë. Deri në shek. XVII – XVIII policia ka pasur kuptim tjetër nga kuptimi bashkëkohor, dhe iu është përshtatur kuptim grek të **politeia**-s: me polici është nënkuptuar drejtimi i degëzuar dhe i komplikuar shtetëror, që ka mbajtur kujdes jo vetëm për interesin shtetëror por edhe për interesin e banorëve. Me veprimtarinë e policisë, qytetarëve iu është dhënë siguria, mirëqenia, por edhe përkryeshmëria. Konsiderohej se shteti është i rregulluar vetëm atëherë kur policia të ketë një polici të tillë që kryen këto funksione për qytetarin. Kjo gjendje ndryshon në shekullin XIX, kur vjen deri te diferencimi i administratës shtetërore, si pasojë e rritjes së shtetit administrativ. Tani dolën në syprinë, duke u dalluar qartë dy funksione të shtetit: i pari, funksioni i promovimit të zhvillimit të shtetit dhe mirëqenies së tij; i dyti, eliminimi apo shkatërrimi i rreziqeve që shtetit, si pjesë e shoqërisë, i vijnë nga brenda. Me këtë vjen deri te ngjizja e procesit të diferencimit të administratës shtetërore, që as sot nuk ka përfunduar. Administrata e brendshme ndahet në disa resorë ose lëmi. Në këtë mënyrë, administrata e dikurshme gjithëpërfshirëse e brendshme koncentrohet në punët e brendshme, por edhe nën këtë emër akoma ruan kujtimin në gjerësinë e dikurshme. Në shumicën e vendeve të **Evropës**, resori i punëve të brendshme përcaktohet negativisht – në fushën e tij të veprimit hyjnë të gjitha punët që nuk iu janë lënë resorëve të tjerë të administratës. Kjo shpjegon larushinë e detyrave të policisë si organ ekzekutiv i punëve të brendshme. Në këtë mënyrë, në disa vende mbrojtja e rendit nga kundërshtarët e brendshëm i besohet policisë shtetërore, kurse nga kundërshtarët e jashtëm – shërbimit kundërinformativ. Veprimtaria tjetër policore, që nuk ka për detyrë mbrojtjen e rendit të brendshëm, në disa vende ndahet në **policinë gjyqësore** ("police judiciaire"), detyrë e së cilës është të kryej hetime dhe procedurën e hetimeve në çështjet penale, dhe në **policinë administrative** ("police administrative"), detyrë e së cilës është mbajtja e rendit publik ("l'ordre public"). Policia gjyqësore, me fjalë të tjera, ka për detyrë zbulimin e veprave penale dhe delikteve të tjera, hetimi i kryesve të tyre dhe dorëzimi në gjyq i të njëjtëve. Policia administrative, përkundrazi, nuk vihet në lidhje me veprat penale dhe deliktet por me rendin publik: ajo synon ruajtjen e rendit publik, pa marrë parasysh shkaktimin e veprave penale dhe delikteve.[355] Për këtë arsye, policia gjyqësore ka karakter represiv, kurse policia administrative karakter preventiv. Ekziston mundësia

[355] Cf. më shumë në Bernard Stirn "Constitution et droit administratif" Les Nouveaux Cahiers du Conseil constitutionnel Vol. 4 No 37 (2012), fq. 5-19; Patrick Wachsmann, "Le Conseil constitutionnel et le principe de séparation des autorités administrative et judiciaire" *JUS POLITICUM. Revue de droit politique* No. 20-21 (Julliet 2018), fq. 237-260.

e ndarjes së policisë edhe në njësi të tjera të posaçme organizative - për komunikacion, për dukuritë negative shoqërore (alkoholi, droga, prostitucioni), kundër zjarrit dhe fatkeqësive të tjera natyrore, delikuencën e të miturve, për ndërhyrje në situata të jashtëzakonshme dhe kështu me radhë.

Sikundër e kemi sqaruar, me fitoren e revolucioneve borgjeze në fund të shek. XVIII ka fituar ideja e **sovranitetit popullor**. I kuptuar si trupë zgjedhore, sovraniteti popullor është burim dhe arsyeje pushtetit shtetëror. Zbatimi i kësaj ideje nënkupton që banorët e shtetit nga të nënshtruarit dhe të dëgjueshmit (objekt shtetëror) kthehen në shtetas (subjekte shtetërore) dhe, instancë të fundit, në burim të legjitimitetit të pushtetit shtetëror. Me këtë, policia e deriatëhershme has në kundërthënie – që njëkohësisht të përdor fuqinë shtetërore ndaj shtetasve dhe të ketë respekt ndaj tyre si burim i fundit i pushtetit shtetëror, të cilit policia i shërben. Këtë kundërthënie e zgjidh parimi nisës i shtetit të së drejtës, sipas së cilit shteti dhe policia e tij janë të lidhura dhe i nënshtrohen të drejtës njëjtë sikur të gjithë qytetarët. Policia merr rolin rreptësisht ekzekutiv, ajo bëhet ekzekutuese e normave juridike, por që në këtë veprimtari ajo është e lidhur për dispozita juridike dhe i nënshtrohet kontrollit juridik. Kjo sot përbën kuadrin dhe parimin themelor, në të cilin, funksionalisht dhe organizativisht, futet **policia** si një pjesë e aparatit shtetëror.

Funksioni themelor i policisë si organ shtetëror lidhet me kuptimin e **rendit publik**. Mbajtja e rendit publik përfshinë komponentët për sa vijon: 1. Pengimi i rrënimit të rendit publik; 2. Represioni ndaj atyre që e rrënojnë rendin publik; 3. Krijimi dhe ruajtja e kushteve për stabilizim të rendit publik. Në kuptimin e gjerë, rendi publik përfshinë rendin e themeluar përmes kushtetutës dhe rregullave të tjera juridike të një vendi (institucionet politike, liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të qytetarit – funksionalizimi dhe realizimi i tyre, marrëdhëniet reciproke mes tyre dhe institucioneve politike). Në këtë kuptim, rendi publik barazohet me rendin juridik-kushtetues të vendit, përkatësisht me sistemin e institucioneve politike, marrëdhënieve dhe të drejtave të konstituuara dhe mbrojtura nga e drejta. Çdo veprimtari kundërligjore e drejtuar kundër rrënimit të rendit juridiko-kushtetues të kuptuar kësisoj paraqet rrezikim të rendit publik. Me këtë rast, pjesa më e madhe e veprimeve kundërligjore ka karakterin e veprave penale, të cilat tërheqin sanksione penale, në ndërkohë që pjesa tjetër e veprimeve antiligjore janë kundërvajtje, për të cilat shqiptohen sanksione administrative dhe masa mbrojtëse. Nën kulmin e mbrojtjes së rendit publik hyn edhe mënjanimi i pengesave të tjera që përbëjnë pengesë për funksionimin normal të rendit juridiko-kushtetues (sigurimi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, sigurimi i punës pa pengesa të tubimeve publike, mbrojtja e komunikacionit në komunikacionin publik). Nga kjo del se, rrjedhimisht, policia paraqet një veprimtari drejtuese me qëllim të ruajtjes së rendit publik. Mbrojtja e rendit publik përfshinë zbatimin e dhunshëm të ligjeve, mbajtja e rendit juridiko-kushtetues, mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve, si nga shkelësit e ligjit në mesin e popullsisë, ashtu edhe nga rreziqet natyrore, siç janë zjarret, vërshimet ose fatkeqësitë tjera natyrore.

Vëllimi i punës së policisë varet nga marrëdhënia e forcave shoqërore dhe politike në shoqëri. Kur kjo marrëdhënie përshkohet nga mosdurimi dhe kundërshtia deri në armiqësi, roli policisë bëhet i rëndësishëm. Anasjelltas, në vendet ku ekziston një kohezion i madh shoqëror, roli policisë zvogëlohet. Në vëllimin e funksioneve të policisë ndikojnë edhe dy faktorë të tjerë. I pari lidhet me rritjen e aparatit shtetëror dhe shkalla e ndërhyrjes së shtetit në marrëdhënie shoqërore. Rritja e aparatit shtetëror dhe intervencionizimit shtetëror çon deri te rritja e vëllimit të policisë. Në anën tjetër, kërkesa për kufizimin dhe humanizmin e pushtetit shtetëror dhe të aparatit represiv shtetëror në përgjithësi, ndikon si në ndryshimin e metodave që përdor policia ashtu edhe në vetë vëllimin e policisë. Përkundër që, në thelb, funksionet e policisë janë të ngjashme në shumicën e shteteve, ato nuk janë përmbajtjesisht të njëjta, për shkak se në vëllimin dhe përmbajtjen e veprimtarisë së policisë thellësisht ndikon karakteri i rregullimit shoqëror dhe shtetëror të secilit vend veç e veç.

Te organizimi i policisë me qëllim të kryerjes së funksionit të saj, paraqiten disa probleme, siç janë, ta zëmë: a duhet ndarë policia organizativisht sa më shumë si një organizatë e posaçme, apo duhet futur në tërësinë e organizatës shtetërore, si pjesë e tërësisë më të gjerë; a duhet organizuar policinë në baza centraliste si një shërbim të integruar, apo pranë policisë shtetërore duhet organizuar policitë lokale me qëllim përshtatjen më të lehtë ndaj kushteve lokale; a duhet paraparë në organizatën policore forma që janë të përshtatshme për përdorim të vlerësimit diskrecional me rastin e vendimmarrjes, apo të lidhet fuqishëm organizativisht me ligjin dhe t'i nënshtrohet mbikëqyrjes permanente dhe efikase; a duhen nxitur forma organizative të përshtatshme për vetëiniciativë apo t'i jepet përparësi formave të zgjidhjes së rasteve ashtu siç paraqiten në praktikë; a duhet ndarë policinë që merr pjesë drejtpërdrejtë në procedura gjyqësore nga policia që mbetet pjesë e administratës etj. Këto janë disa nga dilemat që paraqiten çdo herë me rastin e organizimit të policisë, caktimit të rolit dhe pozitë së saj në shoqëri. Ajo që ka rëndësi këtu të thuhet është se, nga aspekti i të drejtës kushtetuese, me rastin e organizimit të sistemit konkret të policisë nuk duhet kaluar në zgjidhje ekstreme të ndonjërës prej dilemave si më sipër, por duhet gjetur një baraspeshë optimale mes tyre. Orientimi ndaj këtyre dilemave nuk varet vetëm nga rrethanat politike konkrete në një vend, por edhe nga traditat historike, si dhe nga rrethanat tjera të posaçme.

Policia e përgjithshme ose **policia qendrore** organizohet për nevojat ose nën kontrollin e organeve qendrore shtetërore. Zakonisht gjendet në kuadër të ministrisë së punëve të brendshme, por mund të jetë e lidhur edhe për ushtrinë, si xhandarmërinë ose polici e posaçme ushtarake, si dhe me degët tjera të pushtetit. Në këtë kontekst, shërbimi kundërinformativ mund të organizohet si njësi organizatave në kuadër të policisë së përgjithshme, si njësi në kuadër të shërbimit të posaçëm të sigurimit të shtetit, po edhe si pjesë e shërbimit informativ që pak a shumë në kuadër të ushtrisë. Edhe **policia politike** organizohet në kuadër të sistemit të përgjithshëm policor. Ndarja organizative e **policisë politike** si njësi e posaçme politike tërheq me vete rrezik të dyfishtë: ajo është cilësi dhe karakteristikë e sistemit represiv policor dhe burim permanent i rrezikut për ndryshim të karakterit të pushtetit shtetëror, por edhe të bartësve (titullarëve) të këtij pushteti. Shembulli më i njohur i policisë së tillë është **Gestapo**-ja në **Gjermaninë** naziste. **Xhandarmëria** është formacion special për përdorim të drejtpërdrejtë të forcës në shkallë të gjerë gjatë kryerjes së veprimtarisë policore, si dhe për kryerjen e shërbimit policor lokal në vendet ku nuk ekziston organizimi i policisë lokale. **Xhandarmëria** është organizatë e karakterit ushtarak dhe zakonisht i nënshtrohet komandës së ushtrisë në aspektin hierarkik. Si shembull i xhandarmërisë së suksesshme janë karabinierët italianë ("carabienere"), të cilët janë pjesë e ushtrisë së Italisë, që kryejnë funksione policore në ushtri, por që në rolin e xhandarmërisë kryejnë punët e mbajtjes dhe ruajtjes së rendit publik. Në shumë vende organizohen **polici speciale** për nevojat e resorëve të administratës, përkatësisht ministrive (policia ushtarake pranë ushtrisë, policia financiare pranë ministrisë së financave dhe ngjashëm). **Policinë lokale** e përbëjnë njësitë policore që formohen në kuadër të sistemeve lokale të qeverisjes dhe gjenden nën mbikëqyrjen e organeve lokale. Janë të rralla rastet, megjithatë, kur policia lokale ka mëvetësi e pavarësi dhe është e ndarë nga policia qendrore dhe drejtimit të centralizuar dhe hierarkik të krejt sistemit policor. Për këtë arsye në shumicën e vendeve ku ekziston policia lokale, sistemi qendror policor synon të mbaj një kontroll të konsiderueshëm ndaj policisë lokale.

Problem i përgjithshëm i shteteve me rregullim demokratik është vënia nën kontrolli politik dhe juridik dhe kufizimi dhe civilizimi i përdorimit të forcës shtetërore. Kjo për faktin se policia është shprehje e monopolit të dhunës fizike me të cilën disponon organizatat shtetërore në marrëdhëniet e brendshme. Metoda fillestare policore në kuadër të zhvillimit të metodave policore ka qenë përdorimi i organizuar i dhunës ndaj njerëzve. Qëllimit parësor të demokratizimit të metodave policore në rend të parë i shërben **rregullimi juridik i veprimtarisë së tërësishme të policisë**. Veprimtaria e policisë vihet nën ligj. Për te, si dhe për tërë veprimtarinë shtetërore, vlen **parimi i ligjshmërisë**. Në veçanti e ndjeshme është çështja sesi të sigurohet realizimi **parimit të ligjshmërisë** në raport me procedurat që ndjek policia gjatë ushtrimit të autorizimeve diskrecionale, të cilat i zbaton sipas

vlerësimit të lirë. Në këto procedura, policia nuk është rreptësisht e lidhur me normën juridike, por mund të ushtroj autorizime e ndërmarr veprime në bazë të vlerësimit të lirë të rrethanave. Edhe në situata të tilla, megjithatë, policia është e lidhur për kushte të caktuara, të cilat i nënshtrohen kontrollit të ligjshmërisë. Esenca e rregullimit me norma juridike të veprimtarisë së policisë konsiston në bërjen e saj juridikisht përgjegjëse për veprimet e veta. Demokratizimit të policisë i kontribuon edhe **mbikëqyrja e punës së policisë**, e cila mund të jetë **mbikëqyrje e brendshme** dhe **mbikëqyrje e jashtme**. E para kryhet brenda vetë organizatës policore dhe ministrisë së punëve të brendshme nga ana e instancës më të lartë. E dyta kryhet përmes përdorimit të metodave të ndryshme, siç janë: në parlament, prokurori publike, gjykata, institucione të ndryshme, siç janë avokati popullit e deri te partitë politike dhe shoqatat e qytetarëve.

33. Ushtria dhe policia në Kosovë

Në kapitullin XI, i titulluar si "Sektori Sigurisë" (nenet 125-131), **KKos** normon çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë. Duhet thënë që në fillim se në **KKos** nuk ka asnjë normë që flet për **Ushtrinë e Kosovës** (UKos) dhe as rolin e pozitën e saj kushtetuese, si mbrojtës i sovranitetit dhe integritetit territorial, siç e ka çdo ushtri bashkëkohore. Këtë gjë e përplotësojnë deri në një masë tri ligjet e **Kosovës**, të cilat i shtjellojmë në vijim dhe që në një mënyrë kanë shkaktuar amendamentimin e **KKos**, për faktin se kanë ndryshuar rolin dhe pozitën e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe organit administrativ që drejton këtë forcë, në një mënyrë nuk e njeh **KKos**. Kjo në literaturë cilësohet si **kuazi-amendamentim** kushtetues, pra kur me ligje dhe praktika të tjera që nuk ndjekin rrugët formale të përcaktuara me kushtetutë vjen deri të ndryshimi i kushtetutës ekzistuese.[356]
Kapitulli XI i **KKos** nis me parimet e përgjithshme në sferën e sigurisë. Republika e Kosovës ka pushtet mbi zbatimin e ligjit, sigurinë, drejtësinë, sigurinë publike, inteligjencën, organet civile emergjente dhe mbi kontrollin e kufijve në territorin e vet (neni 125.1 i **KKos**). Institucionet e sigurisë në Republikën e Kosovës mbrojnë sigurinë publike dhe të drejtat e të gjithëve në Republikën e Kosovës. Institucionet veprojnë me transparencë të plotë dhe në pajtim me standardet demokratike e me të drejtat e njeriut të njohura ndërkombëtarisht. Institucionet e Sigurisë duhet të pasqyrojnë shumëllojshmërinë etnike të popullit të Republikës së Kosovës (neni 125.2 i **KKos**). Republika e Kosovës respekton plotësisht të gjitha marrëveshjet e aplikueshme ndërkombëtare dhe ligjin përkatës ndërkombëtar dhe bashkëpunon me organet ndërkombëtare të sigurisë e me homologët rajonalë (neni 125.3 i **KKos**). Kontrolli civil dhe demokratik mbi institucionet e sigurisë garantohet (neni 125.4 i **KKos**). Kuvendi i Republikës së Kosovës mbikëqyr buxhetin dhe politikat e institucioneve të sigurisë, sikur rregullohet me ligj (neni 125.5 i **KKos**). Sikundër shihet, në këtë pjesë mishërohen të gjitha standardet dhe organet relevante kushtetuese që kanë ndikim dhe ushtrojnë mbikëqyrje mbi forcën fizike të shtetit të Kosovës, njëjtë si në vendet tjera demokratike. Kjo pjesë shërben si bazë kushtetuese për realizim të këtyre standardeve nga organet kushtetuese që ushtrojnë autorizime në sferën e mbrojtjes dhe të sigurisë, ani pse KKos, siç shihet, bënë fjalë vetëm për sferën e sigurisë.

FSK-ja është forcë kombëtare e sigurisë për Republikën e Kosovës, dhe mund të dërgoj pjesëtarët e saj jashtë vendit në përputhje të plotë me përgjegjësitë e saj ndërkombëtare (neni 126.1 i **KKos**). Ajo mbron qytetarët dhe komunitetet e Republikës së Kosovës në bazë të kompetencave të përcaktuara me ligj (neni 126.2 i **KKos**). Presidenti i Republikës së Kosovës është Komandant i Përgjithshëm i saj, e cila gjithmonë i nënshtrohet kontrollit të autoriteteve civile të zgjedhura në mënyrë demokratike (neni 126.3 i **KKos**). **FSK** është profesioniste, pasqyron shumëllojshmërinë etnike të popullit të Republikës së Kosovës dhe rekrutohet nga shtetasit e Republikës së Kosovës (neni 126.4 i **KKos**). Komandantin

[356] Cf. më shumë në Vanessa Maçdonnell. "A Theory of Quasi-Constitutional Legislation". *Osgoode Hall Law Journal* Vol. 59 No. 1 (Winter 2016), fq. 508-539; Richard Albert, "Quasi-Constitutional Amendments" Bufalo Law Review Vol. 65 No. 4 (2017), fq. 739-770; Richard Albert, *Quasi-constitutional amendments* (Routledge: London and New York, 2019); Richard Albert and Joel Colón-Ríos (eds.), *Quasi-Constitutionality and Constitutional Statutes. Forms, Functions, Applications* (Routledge: United Kingdom, 2020).

e **FSK-së** e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të rekomandimit të qeverisë. Organizimi i saj i brendshëm rregullohet me ligj (neni 126.5 i **KKos**). Sikundër mund të vërehet, edhe në këtë pjesë mishërohet bazat kushtetuese të operimit të një force që ka karakter imlicit mbrojtës, por që nuk reflektohet në dispozitat kushtetuese në mënyrë shprehimore. Mbikëqyrja dhe kontrolli i punës së FSK, ndërkaq, në tërësi janë në harmoni me standardet e vendeve demokratike lidhur me kontrollin ndaj forcave të armatosura.

Në paragrafin e fundit të nenit 126 të **KKos** thuhet se organizimi i brendshëm i FSK rregullohet me ligj. Ligji, megjithatë, ka ndryshuar rolin dhe pozitën e FSK, jo vetëm organizimin e saj të brendshëm. Ky ndryshim reflektohet në nenin 4 të **Ligjit për FSK**, në të cilin përcaktohen kompetencat dhe detyrat e FSK.[357] **FSK** mbron sovranitetin dhe integritetin territorial, qytetarët, pronën dhe interesat e Republikës së Kosovës (neni 4.1 i Ligjit). **FSK** është forcë ushtarake multietnike, profesionale, e armatosur dhe e autorizuar për të shërbyer në vend dhe jashtë vendit, në pajtim me kompetencat e dhëna kushtetuese dhe ligjore (neni 4.2 i Ligjit). Në paragrafin e tretë dhe të fundit të këtij neni përcaktohen detyrat e përgjithshme të **FSK**, të cilat janë si vijon: 3.1. Mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës; 3.2. Mbështetja ushtarake autoriteteve civile; 3.3. Pjesëmarrja në operacionet ndërkombëtare (neni 4.3 i Ligjit). Mbi bazën e këtyre kompetencave dhe detyrave ligjore është bërë edhe organizimi i brendshëm i **FSK**, në nenin 23 që normon organizimin dhe strukturën e **FSK**, që në tërësi përputhet me organizimin e ushtrive moderne nëpër vendet demokratike. Në nenin 14 jepen dispozitat mbi kontrollin dhe mbikëqyrjen civile demokratike të FSK. **FSK** i nënshtrohet kontrollit civil demokratik, sundimit të ligjit dhe obligimeve ndërkombëtare (neni 14.1 i Ligjit). Kuvendi i Republikës se Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës përbëjnë zinxhirin e kontrollit civil dhe mbikëqyrjes demokratike të FSK-së, siç është përcaktuar me **KKos**, me këtë ligj dhe me ligjet tjera përkatëse (neni 14.2 i Ligjit). Këto konfirmohen me tri ligjet të tjera. Me nenin 4.1 të **Ligjit për Ministrinë e Mbrojtjes**, Ministria e Mbrojtjes përcaktohet si organ i administratës shtetërore i përbërë nga nëpunësit civilë dhe nga personeli ushtarak i FSK-së; nëpunësit civilë të punësuar në Ministri dhe në FSK, përveç të emëruarave politikë, janë pjesë e shërbimit civil të Republikës së Kosovës dhe ruajnë parimin e ekuivalencës në shërbim dhe paga me gradat ushtarake, në pajtim me legjislacionin ne fuqi. Kjo natyrë e këtij resori shtetëror tutje reflektohet në kompetencat e saj (neni 5 i Ligjit), të cilat në pjesën dërrmuese korrespondojnë me kompetencat e një organi të administratës shtetërore që kryen punë në sferën e mbrojtjes.[358] Kjo qasje tutje konfirmohet me **Ligjin për Shërbim në FSK**, ku përcaktohet se mbushja e radhëve bëhet me rekrutim përmes kontratës, si për pjesëtarët aktiv ashtu edhe në rata në rezervë (neni 5 i Ligjit).[359] Nga këto tri ligje, **Ligji Nr.08/L-036 për dërgimin e FSK jashtë vendit** më së shumti reflekton frymën dhe shpirtin e nenit 126.1 të **KKos**.[360] Ky ligj përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e institucioneve në rastet e dërgimit të kontingjentit të FSK - së jashtë vendit si dhe procedurat për dërgim në operacione në mbështetje të paqes, operacione humanitare, trajnime dhe ushtrime jashtë vendit, mënyrën e tërheqjes dhe mënyrën e financimit. Të gjitha këto ligje, siç u tha, përfaqësojnë **kuazi-amendamentim kushtetutes** për aq sa ndryshojnë rolin dhe pozitën kushtetuese të FSK. Ato, megjithatë, kanë një vlerë të përkohshme: neni 14.1.3 i **Ligjit për FSK-në** përcakton se Kuvendi duhet të miratojë buxhetin vjetor dhe planin afatgjatë dhjetëvjeçar të **FSK-së**. Kjo dispozitë, përveç që ka ndryshuar rolin dhe pozitën kushtetuese të **FSK-së**, Kuvendit të Kosovës i ka dhënë kompetencë shtesë për një çështje me interes të përgjithshëm, në kuptim të nenit 65.14 të **KKos**.[361]

---

357 **LIGJI Nr. 06/L-123 PËR FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS**. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*/ Nr. 1/04 JANAR 2019, PRISHTINË (me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme).

358 **LIGJI Nr. 06/L-122 PËR MINISTRINË E MBROJTJES.** *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*/Nr. 1/04 JANAR 2019, PRISHTINË (me ndryshimet dhe plotësimet e mëpastajme).

359 **LIGJI Nr. 06/L-124 PËR SHËRBIM NË FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS**. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* / Nr. 1 / 04 JANAR 2019, PRISHTINË (me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme).

360 **Ligji Nr.08/L-036 për dërgimin e FSK jashtë vendit.** *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*/Nr. 12/29 DHJETOR 2021, PRISHTINË.

361 Për një shtjellim të shkëlqyer të teorisë dhe praktikës së kuazi-amendamentimit në kontekstin kosovar, cf. më

Para se të filloj normomin e **Policisë së Kosovës**, me nenin 127 të KKos rregullohet roli dhe pozita kushtetuese e një organi mjaft të rëndësishëm dhe me rëndësi kushtetuese - **Këshillin e Sigurisë së Kosovës** (KSKos). Ky organ, në bashkëpunim me presidentin e Republikës së Kosovës dhe qeverinë, përgatit strategjinë e sigurisë për vendin. Përveç kësaj, **KSKos** ka edhe rol këshillues në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë në vend (neni 127.1 i **KKos**). Kryesohet nga kryeministri me mbështetje nga qeveria, përveç gjatë periudhës së gjendjes së jashtëzakonshme, sikurse është parashikuar me **KKos** (neni 127.2 i **KKos**). Presidenti mund të kërkojë takime të **KSKos**, dhe Këshilli është i obliguar të bashkërendojë punën e tij ngushtësisht me presidentin. Paragrafi i tretë i këtij neni ngarkon një detyrim në **KSKos**, i cili duhet të bashkëpunojë ngushtësisht me autoritetet ndërkombëtare (neni 127.3 i **KKos**). Anëtarët e tij emërohen dhe shkarkohen në mënyrën e përcaktuar me ligj (neni 127.4 i **KKos**).

Policia e Republikës së Kosovës mban përgjegjësinë për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në tërë territorin e Republikës së Kosovës (neni 128.1 i **KKos**). Ajo konsiderohet strukturë profesioniste që pasqyron shumëllojshmërinë etnike të popullit të Kosovës (neni 128.2 i **KKos**). Kryeministri emëron **Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë** së Republikës së Kosovës, me rekomandimin e qeverisë dhe në pajtim me ligjin. Organizimi i brendshëm i Policisë së Kosovës, rregullohet me ligj (neni 128.3 i **KKos**). Policia ka zinxhir të unifikuar komandues në tërë Republikën e Kosovës, me stacione policore të cilat korrespondojnë me kufijtë komunalë. Ajo lehtëson bashkëpunimin me autoritetet komunale dhe udhëheqësit e bashkësive përmes themelimit të **Këshillave Lokale**, sikur është rregulluar me ligj. Përbërja etnike e policisë brenda një komune duhet të pasqyron, deri në shkallën më lartë të mundshme, përbërjen etnike të popullsisë brenda komunës përkatëse (neni 128.4 i **KKos**). Policia mban përgjegjësinë për kontrollin e kufirit në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me autoritetet vendore dhe ndërkombëtare)neni 128.5 i **KKos**). Nga kjo shihet qartë se Policia ka autorizime për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në tërë territorin e Kosovës. Ajo që ka rëndësi është se struktura e saj komanduese është unike, përkundër që me një marrëveshje të lidhur mes Kosovës dhe Serbisë në vitin 2013, **Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë**, komandantët lokalë të policisë në veri të Kosovës emërohen me lejen e komunitetit serb atje.[362]

Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI) zbulon, heton dhe mbikëqyr kërcënimet ndaj sigurisë në Republikën e Kosovës (neni 129.1 i **KKos**). Ajo është profesioniste, politikisht e paanshme, shumetnike dhe i nënshtrohet mbikëqyrjes nga Kuvendi në mënyrën e përcaktuar me ligj (neni 129.2 i **KKos**). Presidenti i Republikës dhe kryeministri, pas konsultimit me qeverinë, së bashku emërojnë drejtorin, zëvendësdrejtorin dhe inspektorin e përgjithshëm të AKI-së. Kualifikimi dhe mandati, rregullohen me ligj (neni 129.3 i **KKos**). Presidenti dhe kryeministri marrin të njëjtat informacione në lidhje me inteligjencën (neni 129.4 i **KKos**).

Autoriteti Civil i Aviacionit (ACI) rregullohet me nenin 130 të KKos, në dy paragrafë, para kategorisë së gjendjes së jashtëzakonshme. **ACI-ja** rregullon veprimtarinë e aviacionit civil në Republikën

shumë në *Luz Balaj, Florent Muçaj, "*QUASI-CONSTITUTIONAL AMENDMENTS AS A SOLUTION FOR "CONSTITUTIONAL CHANGES" IN COUNTRIES WITH ETHNIC DISPUTES. THE CASE OF KOSOVO". *The Lawyer Quarterly* Vol 13, No 1 (2023), fq. 18-29.

362 "9. Do të ketë një Komandant Rajonal të Policisë për katër komunat veriore me shumicë serbe (Mitrovica Veriore, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi). Komandanti i këtij rajoni do të jetë një serb i Kosovës i nominuar nga Ministria e Punëve të Brendshme nga lista e ofruar nga katër kryetarët e komunave në emër të Bashkësisë/ Asociacionit. Përbërja e PK-së në veri do të reflektojë përbërjen etnike të popullatës së katër komunave. (Do të ketë Komandant tjetër rajonal për komunat e Mitrovicës Jugore, Skënderajit dhe Vushtrrisë). Komandanti rajonal i katër komunave veriore do të bashkëpunojë me komandantë tjerë rajonal". **LIGJI NR. 04/L-199 PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË PARË NDËRKOMBËTARE TË PARIMEVE QË RREGULLOJNË NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE MES REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE REPUBLIKËS SË SERBISË.** *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*/Nr. 38/17 SHTATOR 2013, PRISHTINË.

e Kosovës dhe është ofrues i shërbimeve të navigacionit ajror, sikur është përcaktuar me ligj (neni 130.1 i **KKos**). Ai bashkëpunon plotësisht me autoritetet relevante ndërkombëtare dhe vendore, të përcaktuara me ligj (neni 130.2 i **KKos**).

Presidenti i Republikës mund të shpall **gjendjen e jashtëzakonshme** në këto raste: (1) kur ka nevojë për masa emergjente të mbrojtjes; (2) kur ka rrezik të brendshëm ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike; dhe (3) kur ka fatkeqësi natyrore, e cila prek tërë territorin e Republikës së Kosovës ose një pjesë të tij (neni 131.1 i **KKos**). Nga kjo del se trajtat e gjendjes së jashtëzakonshme në **KKos** janë tri: një, masat emergjente që lidhen me sëmundjet dhe epidemitë masive që prekin tërë territorin e vendit ose pjesë të saj; dy, rrezikimi i rendit kushtetues dhe i sigurisë së jetës së njerëzve dhe pronës së tyre që shkaktohet nga faktori njeri (demonstratat dhe protestat në shkallë të rënd, rebelimi, kryengritja etj.); dhe, tre, fatkeqësitë natyrore që prekin tërë vendin ose vetëm pjesët e caktuara të tij. Në kushtetutat e vendeve fqinje dhe më gjerë, bëhet dallimi mes gjendjes së jashtëzakonshme dhe gjendjes së luftës ose rrezikut të drejtpërdrejtë nga lufta. Në Kosovë, siç shihet, ky dallim nuk ekziston dhe lufta dhe rrezikimi i drejtpërdrejtë nga lufta nuk përcaktohen si shkaqe të dhëna me **KKos** për ndërmarrjen e masave të posaçme të mbrojtjes së rendit dhe sigurisë, të jetës dhe pronës së qytetarëve. Përkundër kësaj, megjithatë ekzistojnë disa cilësi të përbashkëta mes zgjidhjeve kushtetuese në Kosovë dhe vendet përreth, që i japim në vijim. Cilësi e parë e gjendjes së jashtëzakonshme ose kategorive të tjera të ngjashme me te, si në Kosovë ashtu dhe në vendet përreth, është se në raste të tilla nuk vjen deri te suspendimi i kushtetutës së vendit. Këtë standard e përmban edhe ky paragraf i këtij neni të KKos, por edhe të gjitha kushtetutat përreth Kosovës. Një cilësi tjetër e kësaj gjendjeje është se, kufizimet mbi të drejtat dhe liritë e garantuara me kushtetutë, bëhen vetëm deri në shkallën e nevojshme, për sa më pak kohë që të jetë e nevojshme dhe në përputhje të plotë me kushtetutë. Kjo përcaktohet edhe në këtë paragraf të këtij neni të **KKos**. Cilësia e tretë, që përcaktohet me këtë paragraf të këtij neni, është se gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, ligji për zgjedhjet e Kuvendit dhe të komunave nuk mund të ndryshohet. Ky standard mishërohet në të gjitha kushtetutat e vendeve përreth. Së fundi, në KKos përcaktohet që parimet e tjera për veprimet e institucioneve publike gjatë gjendjes së jashtëzakonshme rregullohen me ligj, por ato nuk duhet të jenë në shpërputhje me përcaktimet nga ky nen (neni 131.2 i **KKos**). Akoma një ligj i tillë nuk ekziston, deri në momentin e shkrimit të këtyre rreshtave (shkurt 2023).

Nëse paraqitet nevoja për marrjen e masave emergjente të mbrojtjes, presidenti i Kosovës, pas konsultimit me kryeministrin, shpall gjendjen e jashtëzakonshme. Me shpalljen e kësaj gjendjeje, presidenti Kosovës shpallë menjëherë dekretin, i cili përcakton natyrën e kërcënimit dhe çfarëdo kufizimi për të drejtat dhe liritë. Brenda dyzet e tetë (48) orësh, Kuvendi mund të japë pëlqimin me dy të tretat (2/3) e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Nëse nuk jepet pëlqimi, dekreti i Presidentit nuk ka forcë as efekt (neni 131.3 i **KKos**). Nëse ka rrezik ndaj rendit kushtetues dhe sigurisë publike në Republikën e Kosovës, ose ekziston një fatkeqësi natyrore në tërë territorin e Republikës së Kosovës ose një pjesë të tij, presidenti i Kosovës, në konsultim me kryeministrin, mund të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme. Me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, presidenti shpall menjëherë një dekret, i cili përcakton natyrën e gjendjes së emergjencës dhe çfarëdo kufizimi mbi të drejtat dhe liritë. Brenda dyzet e tetë (48) orësh, Kuvendi mund të japë pëlqimin e tij me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Nëse nuk jepet pëlqimi, dekreti i presidentit nuk ka forcë as efekt (neni 131.4 i **KKos**). Gjendja e jashtëzakonshme zgjat për aq kohë sa vazhdon të kërcënojë rreziku dhe nuk mund të zgjatë më shumë se për një periudhë prej gjashtëdhjetë (60) ditësh. Me pëlqimin e shumicës së deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë, gjendja e jashtëzakonshme, nëse është e nevojshme, mund të zgjatet për periudha pasuese prej tridhjetë (30) ditësh, por jo më shumë se për nëntëdhjetë (90) ditë shtesë gjithsej (neni 131.5 i **KKos**). Kuvendi mund të vendosë kufizime të tilla, sipas nevojës, për sa i përket kohëzgjatjes dhe shkallës së gjendjes së jashtëzakonshme. Kur presidenti konstaton se rreziku ndaj Republikës së Kosovës është i natyrës së jashtëzakonshme, Kuvendi mund të vendos që gjendja e jashtëzakonshme të zgjasë më shumë se njëqind e pesëdhjetë (150) ditë, vetëm nëse për të votojnë

dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit (neni 131.6 i **KKos**). 7. Presidenti i Kosovës, pas konsultimit me Qeverinë dhe Kuvendin, mund të urdhërojë mobilizimin e FSK-së, për të ndihmuar në gjendjen e jashtëzakonshme (neni 131.7 i **KKos**). 8. Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës, vetëm gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, ushtron funksione ekzekutive që kufizohen në funksionet që ndërlidhen në veçanti me gjendjen e jashtëzakonshme. Gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës do të drejtohet nga presidenti i Kosovës, sikur rregullohet me ligj. Gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës do të bashkëpunojë ngushtësisht me qeverinë, kuvendin dhe autoritetet ndërkombëtare (neni 131.8 i **KKos**). Ligji përcakton parimet, lëmit dhe mënyrën e kompensimit të dëmeve të shkaktuara si pasojë e kufizimeve të vendosura gjatë gjendjes së jashtëzakonshme (neni 131.9 i **KKos**). Aktualisht, në kohën e shkrimit të këtyre rreshtave, akoma nuk ekziston një ligj i tillë (shkurt 2023).

34. Ushtria dhe policia në Shqipëri

KShq flet për forcat e armatosura në pjesën e pesëmbëdhjetë (nenet 166-169), kurse për masat e jashtëzakonshme në pjesën e gjashtëmbëdhjetë (nenet 170-176). Në KShq nuk flitet as për policinë dhe as për **Shërbimin Informativ i Shtetit** (SHISH). Dy këto institucione konsiderohen kategori ligjore. Për policinë flitet vetëm në dy nene: në nenin 69 në kontekst të asaj se kush nuk mund të kandidoj për deputetë; dhe në nenin 173, në kontekst të masave të jashtëzakonshme dhe rolit të policisë në to. **SHISH-i**, ndërkaq, përmendet vetëm në kontekst të kompetencave të Presidentit të Republikës (neni 92.1 nën ”f” i **KShq**)

Shtetasit shqiptarë kanë për detyrë të marrin pjesë në mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë, siç parashikohet në ligj (neni 166.1 i **KShq**). Shtetasi që, për arsye ndërgjegjeje, nuk pranon shërbimin me armë në Forcat e Armatosura (FASH), është i detyruar të kryejë një shërbim alternativ, siç parashikohet në ligj (neni 166.2 i **KShq**). D.m.th. këtu bëhet fjalë për kategorinë e refuzimit të shërbimit ushtarak për shkaqe religjioze dhe të ndërgjegjes. Ushtarakët e shërbimit aktiv nuk mund të zgjidhen ose të emërohen në detyra të tjera shtetërore dhe as të marrin pjesë në parti ose në veprimtari politike (neni 167.1 i **KShq**). Pjesëtarët e FASH-it ose personat që kryejnë shërbim alternativ, gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë kushtetuese, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe (neni 167.2 i **KShq**). **FASH-i** përbëhen nga forcat tokësore, detare dhe ajrore (neni 168.1 i **KShq**). Presidenti i Republikës është Komandant i Përgjithshëm i FASH-it (neni 168.2 i **KShq**). Këshilli i Sigurimit Kombëtar është organ këshillimor i Presidentit të Republikës (neni 168.3 i **KShq**). Presidenti, në kohë paqeje, ushtron drejtimin e FASH-it nëpërmjet kryeministrit dhe ministrit të Mbrojtjes (neni 169.1 i **KShq**). Presidenti, në kohe lufte, emëron dhe shkarkon komandantin e FASH-it, me propozim të kryeministrit (neni 169.2 i **KShq**). Presidenti, me propozim të kryeministrit, emëron dhe shkarkon shefin e Shtabit të Përgjithshëm, si dhe, me propozim të ministrit të Mbrojtjes, emëron dhe shkarkon komandantët e forcave tokësore, detare dhe ajrore (neni 169.3 i **KShq**). Kompetencat e Presidentit të Republikës si komandant i përgjithshëm i FASH-it dhe ato të komandantit të FASH-it dhe varësia e tyre nga organet kushtetuese, caktohen me ligj (neni 169.4 i **KShq**).

Masat e jashtëzakonshme mund të vendosen për shkak të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe zgjatin për aq kohë sa vazhdojnë këto gjendje (neni 170.1 i **KShq**). Sikundër shihet, këtu bëhet dallimi qartë mes gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme dhe gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Parimet e veprimtarisë së organeve publike dhe shkalla e kufizimit të të drejtave dhe lirive të njeriut gjatë gjithë periudhës së ekzistencës së gjendjeve që kërkojnë marrjen e masave të jashtëzakonshme, përcaktohen me ligj (neni 170.2 i **KShq**). Ligji duhet të përcaktojë parimet, fushat dhe mënyrën e kompensimit të humbjeve që vijnë si rezultat i kufizimit të të drejtave dhe lirive gjatë marrjes së masave të jashtëzakonshme (neni 170.3 i **KShq**). Aktet që ndërmerren si pasojë e marrjes së masave të jashtëzakonshme, duhet të jenë në përpjesëtim me shkallën e rrezikut dhe duhet të synojnë rivendosjen sa më të shpejtë të kushteve për funksionimin normal të

shtetit (neni 170.4 i **KShq**). Gjatë gjendjeve që kërkojnë marrjen e masave të jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohet asnjë prej këtyre akteve: Kushtetuta, ligjet për zgjedhjet për Kuvendin dhe për organet e pushtetit vendor, si dhe ligjet për masat e jashtëzakonshme (neni 170.5 i **KShq**). Gjatë periudhës së zbatimit të masave të jashtëzakonshme nuk mund të zhvillohen zgjedhje vendore, nuk mund të zhvillohet referendum, si dhe nuk mund të zgjidhet një President i ri i Republikës. Zgjedhjet vendore mund të bëhen vetëm aty ku nuk zbatohen masat e jashtëzakonshme (neni 170.6 i **KShq**).

Në rast **agresioni të armatosur** kundër Republikës së Shqipërisë, Presidenti i Republikës, me kërkesë të Këshillit të Ministrave, shpall gjendjen e luftës (neni 171.1 i **KShq**). Në rast kërcënimesh të jashtme ose kur detyrimi për mbrojtje të përbashkët buron nga një marrëveshje ndërkombëtare, Kuvendi, me propozim të Presidentit të Republikës, shpall gjendjen e luftës, vendos gjendjen e mobilizimit dhe të çmobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm (neni 171.2 i **KShq**). Në rastin e nenit 171 paragrafi 1, Presidenti i Republikës i paraqet Kuvendit dekretin për vendosjen e gjendjes së luftës brenda 48 orëve nga nënshkrimi i tij, duke specifikuar të drejtat që kufizohen (neni 172.1 i **KShq**). Kuvendi merr në shqyrtim menjëherë dhe vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve për dekretin e Presidentit (neni 172.2 i **KShq**). Në rast **rreziku për rendin kushtetues dhe për sigurinë publike**, Kuvendi, me kërkesë të Këshillit të Ministrave, mund të vendosë në një pjesë ose në të gjithë territorin e shtetit gjendjen e jashtëzakonshme, e cila zgjat për aq kohë sa vazhdon rreziku, por jo më shumë se 60 ditë (neni 173.1 i **KShq**). Me vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme ndërhyrja e Forcave të Armatosura bëhet me vendim të Kuvendit dhe vetëm kur forcat e policisë nuk janë në gjendje të rivendosin rendin (neni 173.2 i **KShq**). Zgjatja e afatit të gjendjes së jashtëzakonshme mund të bëhet vetëm me pëlqim të Kuvendit çdo 30 ditë, për një periudhë jo më shumë se 90 ditë (neni 173.3 i **KShq**). Për parandalimin ose mënjanimin e pasojave të një **fatkeqësie natyrore** ose **aksidenti teknologjik**, Këshilli i Ministrave mund të vendosë, për një periudhë jo më të gjatë se 30 ditë, gjendjen e fatkeqësisë natyrore në një pjesë ose në të gjithë territorin e shtetit (neni 174.1 i **KShq**). Zgjatja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore mund të bëhet vetëm me pëlqimin e Kuvendit (neni 174.2 i **KShq**).

Së fundi, neni 175 i **KShq** përcakton se cilat të drejta e liri mund të kufizohen e cilat nuk mund të kufizohen në raste e luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme. Gjatë gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme **nuk mund të kufizohen** të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet: 15 (karakteri i pandashëm, i patjetërsueshëm dhe i padhunueshëm i lirive dhe të drejtave të njeriut), 18 (barazia para ligjit dhe mosdiskriminimi), 19 (shtetësia shqiptare), 20 (barazia para ligjit e pakicave kombëtare), 21 (e drejta për jetë), 24 (Liria e ndërgjegjes dhe e fesë), 25 (ndalimi torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues), 29 (parimi legalitetit të veprës penale dhe dënimit, me përjashtim të veprave, të cilat në kohën e kryerjes së tyre, përbënin krime lufte ose krime kundër njerëzimit sipas së drejtës ndërkombëtare; kjo është njëjtë si në nenin 33 të **KKos**), 30 (prezumimi pafajësisë), 31 (të drejtat dhe garancionet procedurale të të dyshuarit dhe të akuzuarit, si p.sh., **habeas corpus**), 32 (ndalimi i vetëinkriminimit), 34 (parimi **ne bis in idem**), 39 paragrafi 1 (ndalimi dëbimit i shtetasve shqiptar), 41 paragrafët 1, 2, 3 dhe 5 (e drejta e pronës dhe e kompensimit të drejtë, sipas procedurës gjyqësore), 42 (gjykimi drejtë dhe i paanshëm), 43 (e drejta e ankesës dhe parimi proporcionalitet), 48 (e drejta e peticionit dhe parashtresës për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave kushtetuese), 54 (mbrojtja e posaçme e fëmijës, nënës dhe të rinjve), 55 (kujdesi shëndetësor) (neni 175.1 i **KShq**). Gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore **mund të kufizohen** të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet: 37 (paprekshmëria e banesës), 38 (lëvizja e lirë), 41 paragrafi 4 (shpronësimi), 49 (e drejta e punës), 51 (e drejta e grevës) (neni 175.2 i **KShq**). Aktet për shpalljen e gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose të gjendjes së fatkeqësisë natyrore duhet të cilësojnë të drejtat dhe liritë që kufizohen sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni (neni 175.3 i **KShq**). Kur Kuvendi nuk mund të mblidhet gjatë gjendjes së luftës, Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Ministrave, ka të drejtë të nxjerrë **akte që kanë fuqinë e ligjit**, të cilat duhet të miratohen nga Kuvendi në mbledhjen e tij më të parë (neni 176 i **KShq**). Nxjerrja e akteve me fuqi ligjore gjatë kohës së gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore përbën një standard shumë të përhapur ne vendet demokratike. Në

KKos, ky standard nuk ekziston. Në vendet tjera përreth Kosovës, siç do të shihet, ekzistojnë zgjidhje pak e shumë e njëjtë me **KShq**.

35. Ushtria dhe policia në Maqedoninë e Veriut

Në kapitullin VII (nenet 122-128 të KMVe) gjenden dispozitat për **Forcat e Armatosura të Maqedonisë së Veriut** (FAMVe) dhe ato mbi gjendjen e luftës dhe gjendjen e jashtëzakonshme. Për policinë dhe shërbimin informativ nuk bëhet fjalë në **KMVe**, njëjtë si në rastin e **KShq**. **Policia** përmendet vetëm në kontekste periferike. Vetëm njëherë zihet në gojë më përmbajtjesisht, si një garancion kushtetues, në nenin 97 të **KMVe**, në të cilin përcaktohet që organet e administratës shtetërore në fushën e mbrojtjes dhe policisë i udhëheqin persona civilë, të cilët drejtpërsëdrejti para zgjedhjes në ato funksione kanë qenë civilë së paku tre vjet. **FAMVe** e mbrojnë integritetin territorial dhe pavarësinë e Republikës (neni 122.1 i **KMVe**). Mbrojtja e Republikës rregullohet me ligj, i cili nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve (neni 122.2 i **KMVe**). Sikundër shihet, ligji miratohet me një shumicë të sforcuar dhe kjo përbën një garancion të fortë kushtetues se sfera e mbrojtjes nuk mund të politizohet lehtë.

Askush nuk ka të drejtë të pranojë okupimin e **Republikës së Maqedonisë së Veriut** ose të ndonjë pjese të saj, thuhet në nenin 123 të **KMVe**, në një dispozitë të vetme. Kjo qasje është mjaftë e shpeshtë në kushtetutat bashkëkohore. Pas këtij neni pasojnë dispozitat që flasin për **gjendjen e luftës** dhe **gjendjen e jashtëzakonshme**, në mënyrë të ndarë. Pra, edhe në KMVe bëhet dallimi në mes të këtyre dy kategorive kushtetuese. Kështu, gjendja e luftës fillon kur paraqitet rreziku i drejtpërdrejtë i luftës nga sulmi ndaj Republikës ose kur Republika është sulmuar ose i është shpallur luftë (neni 124.1 i **KMVe**). Gjendje lufte shpall Kuvendi me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me propozim të Presidentit të Republikës, qeverisë ose së paku të 30 deputetëve (neni 124.2 i **KMVe**). Nëse Kuvendi nuk mund të mblidhet, vendimin për shpalljen e gjendjes së luftës e merr Presidenti i Republikës dhe ia paraqet Kuvendit për konfirmim sapo ai të ketë mundësi të mblidhet (neni 124.3 i **KMVe**). Gjendja e jashtëzakonshme, ndërkaq, paraqitet kur ndodhin fatkeqësi të mëdha natyrore ose epidemi (neni 125.2 i **KMVe**). Ekzistimin e saj në territorin e **Republikës së Maqedonisë së Veriut** ose të një pjese të saj e cakton Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës, qeverisë ose së paku të 30 deputetëve (neni 125.3 i **KMVe**). Vendimi me të cilin caktohet ekzistimi i gjendjes së jashtëzakonshme merret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve dhe vlen më së shumti 30 ditë (neni 125.4 i **KMVe**). Nëse Kuvendi nuk mund të mblidhet, vendimin për ekzistimin e gjendjes së jashtëzakonshme e merr Presidenti i Republikës dhe ia paraqet Kuvendit për konfirmim sapo ai të ketë mundësi të mblidhet (neni 125.5 i **KMVe**).

Në rast të ekzistimit të gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme qeveria në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjin miraton urdhëresa me fuqi ligjore (neni 126.1 i **KMVe**). Autorizimi i Qeverisë që të miratojë urdhëresa me **fuqi ligjore** zgjat deri në përfundimin e gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme, për të cilën vendos Kuvendi (neni 126.2 i i **KMVe**). Edhe këtu, siç shihet, ekziston **kategoria e akteve me fuqi ligjore**, me të cilat menaxhohet gjendja e luftës dhe gjendja e jashtëzakonshme dhe që fati i tyre vendoset në fund, nga përfaqësuesi i sovranit. Gjatë kohës së gjendjes së luftës, nëse Kuvendi nuk mund të mblidhet, Presidenti i Republikës mund ta emërojë dhe shkarkojë qeverinë dhe të emërojë dhe shkarkojë funksionarë, zgjedhja e të cilëve është në kompetencë të Kuvendit (neni 127 i **KMVe**). Mandati i Presidentit të Republikës, qeverisë, gjyqtarëve kushtetues dhe të anëtarëve të **KGJMVe** vazhdohet për aq kohë sa zgjat gjendja e luftës ose gjendja e jashtëzakonshme (neni 128 i **KMVe**).

36. Ushtria dhe policia në Mal të Zi

Edhe në **KMZi** nuk normohet institucioni i policisë dhe i shërbimit të sigurimit të shtetit, Përveçse në mënyrë periferike, si n**ë KMZi dhe KShq, në kontekstin e** ndalimit të organizimit të tyre për grevë, organizimit politik dhe kështu me radhë (nenet 54 dhe 66 të KMZi). Në kapitullin e gjashtë (neni 129 i KMZi) normohet roli dhe pozita kushtetuese e Ushtrisë së Malit të Zi (UMZi). Në kapitullin në vijim (nenet 130-133 i KMZi) rregullohet roli dhe pozita kushtetuese e një organi tjetër – Këshillit të Mbrojtjes dhe Sigurisë (KMSMZi).

UMZi mbron pavarësinë, sovranitetin dhe territorin shtetëror të Malit të Zi, në pajtim me parimet ndërkombëtare mbi përdorimin e forcës (neni 129.1 i **KMZi**). Ajo gjendet nën kontrollin demokratik dhe civil (neni 129.2 i **KMZi**). Anëtarët e UMZi mund të jenë në kuadër të forcave ndërkombëtare (neni 129.3 i **KMZi**). Këto tri parime të këtij kapitulli janë njëkohësisht edhe shtyllat mbi të cilat qëndron koncepti malazez mbi ushtrinë dhe organizimin e mbrojtjes. Shihet qartë se parimet dhe normat ndërkombëtare kanë një vend të posaçëm në përcaktimin e fizionomisë së ushtrisë në këtë vend, por edhe standardet e kontrollit demokratik dhe civil të saj. Pikërisht për këtë qëllim edhe bën fjalë kapitulli i gjashtë, që normon **KMSMZi**. Neni 130 i numëron kompetencat e këtij organi civil në sferën e mbrojtjes dhe sigurisë së Malit të Zi, të cilat janë: 1. Marrja e vendimeve mbi komandimin e UMZi; 2. Analizimi i situatës së sigurisë në vend dhe marrja e vendimeve për ndërmarrjen e masave përkatëse; 3. Caktimi, promovimi dhe shkarkimi i oficerëve të UMZI; 4. Propozimi në Kuvend i shpalljes së gjendjes së luftës dhe gjendjes së jashtëzakonshme; 5. Propozimi i përdorimit të UMZi në forcat ndërkombëtare; 6. Kryerja edhe punëve të tjera të përcaktuara me KMZi dhe ligj (130 i **KMZi**). Ky organ përbëhet nga: presidenti Malit të Zi, kryetari i Kuvendit dhe kryetari i qeverisë (neni 131.1 i **KMZi**). Presidenti Malit të Zi është kryetar i KMSMZi (neni 131.2 i **KMZi**).

Shpallja e gjendjes së luftës dhe gjendjes së jashtëzakonshme janë objekt rregullimi në neneve 132 dhe 133 të KMZi. Kjo gjendje shallet kur ekziston rreziku i drejtpërdrejtë për luftë për Malin e Zi, kur Mali i Zi sulmohet ose i është shpallur luftë (neni 132.1 i **KMZi**). Nëse Kuvendi nuk mund të mblidhet, vendimin për shpalljen e gjendjes së luftës e bjen KMSMZi dhe ia paraqet Kuvendit për ratifikim në momentin kur Kuvendi mund të mblidhet (neni 132.2 i **KMZi**). Gjendja e jashtëzakonshme, ndërkaq, mund të shpallet në territorin e Malit të Zi ose në një pjesë të tij në rastet kur ekzistojnë: 1. Fatkeqësi të mëdha natyrore; 2. Fatkeqësi tekniko-teknologjike dhe ekologjike dhe epidemi; 3. Prishja e rëndë dhe serioze e rendit dhe qetësisë publike; 4. Rrezikimit ose përpjekjes për rrezikim të rendit kushtetues (neni 133.1 i **KMZi**). Nëse Kuvendi nuk mund të mblidhet, vendimin për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme e bie KMSMZi dhe e paraqet për ratifikim në Kuvend në momentin kur ajo mund të mblidhet (neni 133.2 i **KMZi**). Gjendja e jashtëzakonshme zgjat deri të pushojnë rrethanat për të cilat është shpallur (neni 133.3 i **KMZi**).

37. Ushtria dhe policia në Serbi

Çështjet lidhur me mbrojtjen në **KSerb** normohen në tri pjesët e saj: pjesën e pestë (nene 139-141), në kuadër të rregullimit të marrëdhënieve të pushtetit, pjesën e tetë (nenet 200-202), në kuadër të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë dhe, së fundi, pjesën e nëntë (neni 204), në kuadër të dispozitave mbi amendamentimin kushtetues. Në nenin 139 të KSerb, pra në një nen të vetëm, definohet kompetenca e **Ushtrisë së Serbisë** (USerb), sipas nenit me të njëjtin emër: **USerb** mbron vendin nga rrezikimi i armatosur nga jashtë dhe kryen misione të tjera e detyra, në pajtim me **KSerb**, ligjin dhe parimet e të drejtës ndërkombëtare që rregullojnë përdorimin e forcës, thuhet në këtë nen. USerb mund të përdoret jashtë territorit të Republikës së Serbisë vetëm me vendim të Kuvendit të Serbisë (neni 140 i **KSerb**). USerb është nën kontroll demokratik dhe civil (neni 141.1 i **KSerb**). Për USerb miratohet ligji (neni 141.2 i **KSerb**).

Gjendja e jashtëzakonshme normohet në pjesën e tetë. Kur ekziston rrezik i hapur për ekzistencën e shtetit ose qytetarëve, Kuvendi i Serbisë shpall gjendjen e jashtëzakonshme (neni 200.1 i **KSerb**). Vendimi për gjendjen e jashtëzakonshme vlen më së shumti për 90 ditë. Pas skadimit të këtij afati, Kuvendi mund të vazhdoj me vendim gjendjen e jashtëzakonshme edhe për 90 ditë të tjera, me votën e shumicës së deputetëve (neni 200.2 i **KSerb**). Gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme, Kuvendi mblidhet pa ftesë të posaçme dhe nuk mund të shpërndahet (neni 200.3 i **KSerb**). Me rastin e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme Kuvendi mund të përcaktoj masa me të cilat bëhet shmangie nga liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve të garantuara me KSerb (neni 200.4 i **KSerb**). Kur Kuvendi nuk është në gjendje të mblidhet, vendimin **p**ër shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme e marrin bashkërisht Presidenti Republikës, kryetari Kuvendit dhe kryetari qeverisë, sipas kushteve të njëjta sikur **Kuvendi** (neni 200.5 i **KSerb**). Kur Kuvendi nuk ka mundësi të mblidhet, masat me të cilat shmanget nga liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve të garantuara me KSerb mund t'i përcaktoj qeveria, me rregullore, me kundërfirmën e Presidentit të Republikës (neni 200.6 i **KSerb**).

Gjendja e luftës normohet me nenin 2001 të KSerb. Këtë gjendje e cakton Kuvendi (neni 201.1 i **KSerb**). Kur Kuvendi nuk mund të mblidhet, vendimin për shpalljen e gjendje së luftës e marrin së bashku Presidenti Republikës, kryetari Kuvendit dhe kryetari qeverisë (neni 201.2 i **KSerb**). Me rastin e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme Kuvendi mund të përcaktoj masa me të cilat bëhet shmangie nga liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve të garantuara me KSerb (neni 201.3 i **KSerb**). Kur Kuvendi nuk është në gjendej të mblidhet, vendimit për shpalljen e gjendjes së luftës e marrin bashkërisht presidenti Republikës, kryetari Kuvendit dhe kryetari Qeverisë (neni 201.4 i **KSerb**). Sikundër shihet, këtu nuk gjendet fjalia si te gjendja e jashtëzakonshme, që thotë se shpallja e gjendjes së luftës bëhet sipas kushteve të njëjta që vlejnë për Kuvendin. Kur Kuvendi nuk ka mundësi të mblidhet, masat me të cilat shmanget nga liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve të garantuara me KSerb mund t'i përcaktoj presidenti Republikës, kryetari i Kuvendit dhe kryetari i qeverisë (neni 201.4 i **KSerb**). Edhe këtu ka ndryshim, sepse tri organet shtetërore veprojnë në koncert për normimin konkret të shkallës dhe natyrës së shmangieve nga liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, si garancione kushtetuese të vëna gjatë kohës së luftës. Të gjitha masat e ndërmarra gjatë kohës së luftës i ratifikon Kuvendi në momentin që mund të mblidhet (neni 201.5 i **KSerb**). Sikundër shihet, në KSerb nuk ekziston përshkrimi ose definimi se kur ekziston gjendja e luftës, siç ishte rasti me gjendjen e jashtëzakonshme. Një gjendje të tillë e përcakton Kuvendi dhe organet tjera të Serbisë.

Se për cilat shmangie nga liritë dhe të drejtat e njeriut dhe minoriteteve bëhet fjalë, përcaktohet në nenin 2002 të KSerb. Pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme dhe gjendjes së luftës, lejohet shmangia nga liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve të garantuara me KSerb, dhe atë vetëm në masën që është e nevojshme (neni 202.1 i **KSerb**). Ky është elementi i parë i parimit të proporcionalitetit, që duhet të respektohet nga ato organe që kufizojnë këto liri dhe të drejta kushtetuese. Masat e shmangies nuk guxojnë të shkaktojnë dallime në bazë të racës, gjinisë, gjuhës, religjionit, përkatësisë nacionale ose prejardhjes shoqërore (neni 202.2 i **KSerb**). Ky nen e ndalon diskriminimin, por jo në të gjitha bazat, por vetëm në bazë të atyre që u cekën më sipër. Në këtë kuptim, mund të thuhet se komunitetet e njerëzve që nuk bien në kategoritë e mësipërme, ta zëmë komunitetit **LGBT** plus, mund të vihet në pozitë diskriminuese në raste e gjendje së jashtëzakonshme dhe gjendje së luftës, sepse nuk ka asnjë garancion që ndalon diskriminimin ndaj tyre në këto situata. Masat e shmangies pushojnë kur të ndërpritet gjendja e jashtëzakonshme dhe gjendja e luftës (neni 202.3 i **KSerb**). Edhe në KSerb, në paragrafin e tretë të nenit 202, përcaktohen liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, nga të cilat nuk mund të këtë shmangie asnjëherë në kohë luftë dhe gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. Ato janë liritë dhe të drejtat nga nenet si vijon: 23, 24, 25, 26 (dinjiteti dhe personaliteti i njeriut), 28 (ndalimi i dhunës ndaj personit të privuar nga liria dhe ndalimi vetinkriminimit), 32 (e drejta për gjykim të drejtë), 34 (siguria juridike në të drejtën penale: parimi legalitetit, prezumimi pafajësisë, **ne bis in idem**, **habeas corpus**, ndalimi parashkrimit të krimeve kundër luftës, gjenocidit dhe kundër njerëzimit), 37 (e drejta për integritet personal), 38 (e drejta për shtetësi), 43 (liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë), 45

(kundërshtimi ndërgjegjes), 47 (liria e shprehjes së përkatësisë nacionale), 49 (ndalimi i nxitjes së urrejtjes racore, nacionale dhe fetare), 62 (e drejta për martesë dhe barazia e bashkëshortëve), 63 (liria e planifikimit të lindjeve), 64 (të drejtat e fëmijës) dhe 78 (ndalimi asimilimit të dhunshëm).

Në fund, në pjesën e nëntë, në një nen të vetëm përcaktohet **ndalimi i amendamentimit** të KSerb. Kjo ndalesë shprehimisht, si në vendet tjera përreth Kosovës, ka të bëj me gjendjen e jashtëzakonshme **dhe** gjendjen e luftës (neni 2004 i **KSerb**). Në **KSerb** nuk figurojnë dispozita për **policinë** dhe **shërbimin informativ**, që do të thotë se këto konsiderohen institucione ligjore që normohen me ligje të posaçme, njëjtë si në vendet tjera përreth Kosovës.

38. Autoritetet e pavarura rregullative (agjencitë dhe institucionet e pavarura)

Ngritja e shtetit administrativ, me fillim nga gjysma e dytë e shek. XIX, ka rezultuar në diferencimin institucional të pushtetit shtetëror. Kjo nënkupton që sot shumë detyra shtetërore kryhen (realizohen) nga ana e **agjencive dhe institucioneve** që veprojnë në një distancë të konsiderueshme nga institucionet kryesore të legjitimuara në mënyrë demokratike. Kalimi i përgjegjësive shtetërore në trupa të specializuara ka një histori të gjatë, por që gjysma e dytë e shek. XIX e ka vënë në pah këtë fenomen më shumë se çdo herë tjetër në të kaluarën. Mjafton këtu të kujtojmë **Trinity House**, e themeluar në vitin 1514, **Commissioners of Bankrupcy**, e themeluar në vitin 1570 dhe **Bank of England**, themeluar në vitin 1694. Me konsolidimin e shtetit modern si aktor racional, që koincidon me fundin e shek. XVIII, sistemi i trupave të specializuar u duk më pak i dobishëm, sepse u besua që një funksion publik i vënë nën autoritetin e një ekzekutivi të centralizuar, do të mjaftonte për të siguruar veprimin efikas të shtetit. Përveç kësaj, në këtë kohë gjerësisht u besua se sistemi i ekuilibrit mes pushteteve, që ishte në ndërtim e sipër si parim kushtetues, do të mjaftonte për të siguruar kontrollin parlamentar dhe publik të veprimit të qeverisë në sferën e administratës publike.[363] Kjo pritje ndryshoj dukshëm me kalimin e kohës, veçanërisht nga gjysma e dytë e shekullit XIX për shkak të rritjes galopante të funksioneve dhe nevojave të shtetit, që më nuk mund të kryheshin si punë rutinë si në të kaluarën. Këto funksione të reja shtetërore, në veçanti në sferën e mbikëqyrjes sociale, kërkonin specializime të nduarndurshme dhe dije profesionale që nuk mund të gjendej në domenin e organeve politike qendrore të shtetit, që personifikonin sovranitetin politik të shoqërisë. Kjo përbën hapin e parë të diferencimit institucional të pushtetit shtetëror, në rend të parë atij ekzekutiv, por edhe të dy pushteteve të tjera, nga shkaku se sfera e veprimit të autoriteteve të pavarura përfshinë edhe normavënien dhe ndarjen (dhënien) e drejtësisë, siç do të shihet në vijim.

Në doktrinën kushtetuese, diferencimi i pushtetit shtetëror që rrjedh si pasojë e ngritjes së shtetit administrativ ka rezultuar në **diferencimin institucional** të pushtetit shtetëror, ashtu që sot, siç u tha, shumë detyra shtetërore kryhen (realizohen) nga ana e **agjencive dhe institucioneve** që veprojnë në një distancë të konsiderueshme nga institucionet kryesore të legjitimuara në mënyrë demokratike. Zakonisht emërtohen si **autoritete të pavarura** apo **autoritete të pavarura rregullative**, kurse në të drejtën pozitive figurojnë me emërtime të ndryshme, në vartësi të zgjidhjeve kushtetuese dhe ligjore në vendet e ndryshme, siç janë: "komisione", "zyra", "këshilla", "agjenci", etj. Terminologjia, thënë shkurt, nuk është stabile: kështu, ta zëmë, në **Britaninë e Madhe quhen** "trupat publike jodepartamentale" ose "organizatat gjysmëautonome joqeveritare" (Quangos); në **SHBA** ato kane emrin "agjensionet e pavarura rregullative"; në **Francë**, "autoritetet e pavarura administrative"; në Itali, "autoritete garantuese" ("l' autorita garante"); në Rumani "autoritetet e pavarura autonome", etj.[364] Ne do të përdorim njëkohësisht

[363] András Sajó, "Les autorités indépendantes". Në Michel Troper et Dominiques et Chagnollaud (eds.), *Traité international de droit constitutionnel. Tome 2: Distribution des pouvoirs* (Dalloz: Paris, 2012) fq. 321-365 në fq. 325.

[364] Cf. Sandrine Baume, "De l' usage des pouvoirs neutres". *Revue Français d'Histoire des Idées Politiques*, Vol. No. 143 (2012), fq. 17-27, në fq. 24-25; András Sajó, "Les autorités indépendantes", fq. 323-324.**Kosova** në këtë drejtim nuk bën përjashtim: Kapitulli XII ["Institucionet e Pavarura"] i Kushtetutës përbën bazën kushtetuese për themelimin e institucioneve, komisioneve dhe agjencive të pavarura, të cilat luajnë rol të rëndësishëm në moderimin e pushtetit publik në Kosovë.

dy termet, termin **autoritete të pavarura rregullative** dhe **agjenci e institucione të pavarura**, për të përshkruar të njëjtin fenomen.

Organizimi hierarkik tradicional, në krye të të cilit qëndrojnë departamentet e udhëhequra nga ministri apo titullari ekuivalent i ekzekutivit, është zëvendësuar me aranzhmane që formojnë një rrjet të strukturuar të **politikëbërjes** dhe **ofrimit të shërbimeve** nga një numër i trupave publik që operojnë në një distancë nga burimet e autorizuara të pushtetit që buron nga vota e lirë. Në këtë kuptim, vendimet e ndërmarra nga bankat e pavarura qendrore, rregullatorët e sektorit të energjisë, inspektoratet e ndryshme (në shkolla, sektorin shëndetësor dhe siguri, ndotje dhe ambient, pension, polici dhe burgje), si dhe një larushi e trupave të tjerë publik (si p.sh., institutet e shëndetësisë, institucionet e ekselencës klinike, komisionarët e informimit dhe privatësisë etj.) mjaft shpesh kanë më shumë ndikim në politikat publike sesa vendimet e ministrave apo politikanët tjerët të zgjedhur. Këto trupa janë cilësuar si institucione **jomazhoritare** apo, thjeshtë, **trupa të pazgjedhura**, që më së shpeshti përbëhen nga ekspertë që kryejnë funksione publike me mbështetjen e autoriteteve qeveritare dhe në emër të shtetit. Ato, megjithatë, nuk mund të jenë të dirigjuara nga organet politike dhe, si të tilla, gëzojnë një autonomi specifike që i largon nga udhëheqja dhe kontrolli i ekzekutivit politik. Anëtarët e këtij të fundit, **liderët politikë** nominalisht përgjegjës para ligjvënësit për udhëheqjen me ekzekutivin, në praktikë kanë shumë kontroll reale mbi makinerinë qeverisëse dhe aparatit e pushtetit ekzekutiv. Kjo e bën të vështirë përshtatjen e tyre ndaj doktrinës mbi **ndarjen e pushteteve** dhe shkakton konfuzion, sepse liderët politik që shpenzojnë mjaft kohë e mund për të menaxhuar makinerinë administrative, për të cilën janë përgjegjës me kushtetutë, por që në të vërtetë nuk kanë mundësi ta kontrollojnë. [365] Diferencimi institucional, nga i cili kanë lindur dhe janë zhvilluar **autoritetet e pavarura rregullative**, në literaturë është cilësuar si **anomali institucionale** për arsye se bëhet fjalë për një sferë fundamentale të vendimmarrjes dhe aktivitetit shtetëror, që ekziston jashtë kontrollit demokratik dhe, mjaft shpesh, e privuar nga vlera kushtetuese.[366] Në aspektin kushtetues, megjithatë, për aq sa përmenden dhe normohen me kushtetutë, ato **nuk janë asgjë tjetër pos trupa apo organe me rëndësi kushtetuese**, që dallojnë nga organet kushtetuese për shkak se nuk janë shprehje e drejtpërdrejtë e sovranitetit politik të vendit dhe nuk e përfaqësojnë atë.

Autoriteti dhe legjitimiteti i **autoritete të pavarura rregullative** rrjedh nga burime të tjera, gjë që nuk mund të shpjegohet me teorinë standarde të **delegimit të pushtetit publik** nga legjislatura. Kjo rrethanë, së bashku me pranimin gjithnjë e më të madh të tyre si një lloj i ri i pushtetit, përbën një sfidë në vetvete. Në literaturë kjo është quajtur **eforati i ri**,[367] me referim në **eforatin spartan**, i cili ka qenë një trup i zgjedhur që ka kryer punët e shtetit gjatë kohës që mbretërit e **Spartës** ishin të zënë me luftëra dhe punë të tjera.[368] Një autor tjetër, konstitucionalisti i njohur kroat i të drejtës kushtetuese, **Branko**

365 M. J. C. Vile, *Constitutionalism and the Separation of Powers*, fq. 399; Branko Smerdel, *O USTAVIMA I LJUDIMA. Uvod u ustavnopravnu kazuistiku* (Novi Informator: Zagreb: 2012), fq. 29-31.

366 Normimi i tyre me kushtetutë zakonisht bëhet jashtë ndarjes klasike të tri pushteteve, në një mënyrë jo sistematike dhe, sa i përket garancionit të pozitës së tyre kushtetuese, shumë rrallë figuron si normim kushtetues, kryesisht sa i përket garantimit të pavarësisë së mënyrës së nominimit të anëtarëve të tyre.Pas mbarimit të **Luftës së Ftohtë**, në vendet e demokracive tradicionale ka nisur konstitutcionalizimi i autoriteteve të pavarura, si psh. në **Portugali** me reformën kushtetuese në vitin 1997, në **Greqi** në vitin 2001, në **Itali** në vitin 2004 etj. **Kushtetuta e Afrikës së Jugut** e vitit 1996, aktualisht në fuqi, shpreh tendencën e përgjithshme të rregullimit kushtetues të **autoriteteve të pavarura**, sepse në një mënyrë mjaft të detajuar, në kapitullin e nëntë normon rolin dhe pozitën e institucioneve shtetërore që përkrahin mbështesin demokracinë kushtetuese (titulli i vetë kapitullit në fjalë). Ngjashëm më këtë janë edhe stipulimet kushtetuese të shumicës së vendeve ish-komuniste, në të cilat garantohet roli dhe pozita kushtetuese e institucioneve dhe agjencive kryesore të pavarura, siç janë: **auditori i përgjithshëm**, **banka qendrore**, **avokati i populli**, **komisioni qendror i zgjedhjeve** dhe kështu me radhë. Këto kushtetuta përcaktojnë dhe garantojnë pavarësinë organizative, financiare dhe personale, duke lënë që me ligj më pas të normohen modalitetet e realizimit të saj. Kjo ka bërë që në literaturë të konstatohet se ekzistojnë dy modalitete të normimit të rolit dhe pozitës së agjencive dhe institucioneve të pavarura: **modaliteti kushtetues** dhe **modaliteti ligjor** i normimit. Cf. më shumë në András Sajó, "Les autorités indépendantes", fq. 322, 329-331.

367 Martin Loughlin, *Foundations of Public Law*, fq. 448.

368 Në fakt, **eforët** kanë kryer edhe punë të tjera ligjvënëse, gjyqësore, financiare dhe ekzekutive, duke e ndarë pushtetin me mbretërit e **Spartës**. Pushteti kryesor që asocohet me ta është ai i shpalljes së luftës, por edhe i mbikëqyrjes së trupave ushtarake dhe disiplinës së tyre. Në njëfarë mënyre kanë qenë si një lloj guvernerësh në kuptimin modern, por të zgjedhur nga mesi i popullsisë së moshës 30-60 vjeçare, nga çdo shtresë e saj. Cf. më shumë për këtë institucion të lashtë spartan në Nicolas

Smerdel, këto organizma i ka cilësuar si **përbindësha të vërtetë kushtetues**.[369] Sa i përket vendit të tyre në sistemin e përgjithshëm të pushtetit kushtetues, ndërkaq, **autoritet e pavarura rregullative** cilësohen si **pushtet i katërt pa kokë**, si një **forcë e tretë** që është e ndarë nga pushteti politik i zgjedhur. Në të vërtetë, ato i përkasin pushtetit neutral (**pouvoir neutre**):[370] përveç shefit të shtetit dhe gjykatës kushtetuese, me rritjen e shtetit administrativ ka lindur edhe metodologjia tjetër e neutralizimit te pushtetit ekzistues. Këtu, megjithatë, bëhet fjalë për qasje apo metodologji për neutralizim të pushtetit ekzistues, jo për krijimin e **një pushteti të tretë dhe të ndarë nga tri pushtetet klasike**.[371]

Autoritetet e pavarura rregullative operojnë në formë të **agjencive dhe institucioneve të pavarura**, që janë të panumërta në sistemet kushtetuese të vendeve demokratike. Funksionet që kryejnë përfshijnë punët për sa vijon: [372]

- e para, **ofrimi i shërbimeve** (ta zëmë: bankat e pavarura qendrore, si përgjegjës për politikat monetare, rregullatorët e shërbimeve transmetuese, si përgjegjës për shërbimet e transmetimit etj.);
- e dyta, **vlerësimi i rrezikut** (një mori trupash të specializuara që mbledhin informacione shkencore dhe teknike dhe vlerësojnë gjasat për rrezik, duke ushqyer vendimmarrjen politike publike lidhur me një varg çështjesh që kanë të bëjnë, ta zëmë, me sigurinë në ushqim, farmacinë dhe mjekësinë, sportin, mbetjet nukleare, ndotjen e ambientit, shëndetin dhe sigurinë në punë;
- e treta, **mbikëqyrja e kufijve në mes të sektorit publik dhe atij privat**, me qëllim të sigurimit që një kujdes i duhur i kushtohet interesit publik (ta zëmë: rregullatorët e furnizuesve me ujë dhe energji elektrike me qëllim të sigurimit të nuk vjen deri të shfrytëzimi i pozitës monopoliste në treg, agjencitë që sigurojnë konfidencialitetin dhe privatësinë e informatave dhe ruajtjen e tyre etj.);
- e katërta, **auditimi dhe inspektimi**, që tradicionalisht janë marrë me sigurimin që trupat publik shpenzojnë ligjërisht dhe në mënyrë efiçente paratë publike të alokuara për qëllime të përcaktuara publike; dhe
- e pesta, **dhënia e drejtësisë dhe mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut**, ku hyjnë tribunalët, trupat me juridiksion apeli, avokatët e popullit, agjencitë mbikëqyrëse etj., që ofrojnë metoda administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të individit, si alternativë e metodave tradicionale juridike apo politike për kënaqje të drejtësisë dhe mbrojtjen e të drejtave të individëve.

Ani pse **autoritet e pavarura rregullative**, në përgjithësi, nuk ushtrojnë **pushtet shtetëror** në mënyrë të drejtpërdrejtë, veprimet e tyre mund të kenë ndikim të madh në vendimmarrjen politike. Mjaft shpesh, vendimet e tyre kornizojnë autonominë e autoriteteve të zgjedhura shtetërore, duke bërë që ndikimi i politikanëve të zgjedhur mbi proceset e politikave publike të jetë më periferik. Në këtë kuptim, ato mund portretizohen si një rrezik për demokracinë, një shprehje e asaj që filozofi gjerman **Fihte** (Johann Gottlieb Fichte: 1762-1814) e ka cilësuar **aristo-demokraci**.[373] Fenomeni që shprehet me termin autoritetet e pavarura, megjithatë, është më i ndërlikuar. Lindja dhe zhvillimi i tyre shpërfaq një fazë të re në zhvillimin e qeverisjes: përgjatë dy shekujve, politika e organizuar ka synuar të sillet rreth çështjes së shpërndarjes së drejtë të mirave dhe shërbimeve në mes të klasave shoqërore. Kjo ka kërkuar **diversifikimin institucional** të formave tradicionale në të cilat është prezantuar organizimi i pushtetit shtetëror. Në këtë

Richer, *Les éphores: études sur l'histoire et sur l'image de Sparte (VIIIe-IIIe siècle avant Jésus-Christ). Histoire ancienne et médiévale / Université de Paris I, 50* (Publications de la Sorbonne: Paris, 1998).

369 Branko Smerdel, *O USTAVIMA I LJUDIMA*, fq. 30.

370 András Sajó, "Les autorités indépendantes", fq. 324.

371 Cf. më shumë për këtë në Enver Hasani, *E DREJTA KUSHTETUESE. Studim kritik mbi librin "E drejta kushtetuese" të autorëve A. Bajrami e F. Muçaj* (Jalifat Publishing: Hjuston, Teksas, 2018).

372 András Sajó, "Les autorités indépendantes", fq. 344-357.

373 J. G. Fichte, *Foundations of Natural Rights According to the Principles of the Wissenschaftslehre* [1796] Michael Baur (trans) Frederick Neuhouser (ed) (Cambridge University Press: Cambridge, 2000) fq. 143.

diversifikim hyn kategoria e **autoriteteve të pavarura rregullative**, të cilat si një fenomen shoqëror në gjirin e tyre përfshijnë zyrtarë publik që posedojnë njohuri dhe ekspertizë të specializuar që shërben si bazë e vendimmarrjes efektive pushtetore. Qeverisja që shpërfaqet nga veprimtaria e autoriteteve në fjalë, krejt puna e tyre, mund të shihet si një faktor që kufizon e strukturon vendimmarrjen politike. Kjo, megjithatë, jo domosdo kufizon shpërfaqjen e demokracisë sepse, mund të thuhet, ato kanë një potencial të madh për fuqizimin e saj: si të tilla imponojnë një disiplinë të rreptë ndaj procesit të politikëbërjes dhe ndaj vetë procesit demokratik. Një rol si ky më së qarti shihet nëse analizohet esenca e qeverisjes si një ushtrim apo përpjekje e vazhdueshme për zgjidhjen e problemeve praktike jetësore: në momentin që qeverisja si një ushtrim i pushtetit trajtohet si një ndërmarrje për zgjidhjen e problemeve të **veprimit kolektiv** përmes proceseve që kërkojnë **arsyetim dhe argumentim të fakteve**, kurse politika si një art i akomodimit racional të dallimeve, atëherë dukshëm qartësohet roli i **autoriteteve të pavarura**.

Zakonisht janë dy faza themelore në procesin e vendimmarrjes publike: përdorimi i dijes në arsyetimin dhe argumentimin e fakteve me rastin e adresimit të problemeve dhe, në dritën e tyre, miratimi (nxjerrja) e një vendimi apo bërja e një gjykimi konkret. Funksioni i **autoriteteve të pavarura rregullative** shprehet pikërisht në faktin se luajnë një rol qendror gjatë fazës së parë. Kjo është kështu për arsye se natyra e tyre e pavarur dhe jozgjedhore paraqet një epërsi kolosale: dija dhe ekspertiza e tyre profesionale përdoren në arsyetimin dhe argumentimin e fakteve përgjatë fazës së parë. Më pastaj kalohet në fazën e dytë të vendimmarrjes apo gjykimit konkret, i cili bazohet në të gjeturat e fazës së parë. Me këtë rast, dija dhe ekspertiza profesionale përdoren si mënyrë institucionale e neutralizimit të pushtetit klasik, jo përmes ndarjes së tij por përmes diferencimit institucional që bazohet në dije të ngushtë dhe ekspertizë profesionale.[374] Këto dy cilësi bëjnë që ato të ndihmojnë në prodhimin e **dijes objektive** me rastin e adresimit të ndonjë çështje politike. Në këtë kuptim, mund të argumentohet se ky lloj **pushteti specifik** fuqizon demokracinë sepse ofron një ambient më të sigurt për popullin që ai të përfitoj nga ekspertiza dhe gjendja më e fundit e dijes, të mbledh informata që janë të besueshme dhe relevante për te, të bazohet në informacionin e tillë dhe të nxjerr përfundime vetjake, lidhur me veprimet që mund të ndërmerr dhe gjykimet që mund të bëj.

Ngritja dhe faktorizimi i **autoriteteve të pavarura rregullative** ndihmon qytetarët që të dallojnë përbërësit e ndryshëm të politikave publike, përgjegjësitë dhe kontribuesit në këto politika dhe, marrë parasysh informimin e mirë të qytetarëve, të vështirësojë luajtjen me fakte apo qasjen e privilegjuar në dije nga ana e politikës. Ato janë pjesë e **diferencimit të vazhdueshëm institucional** që ka nisur me fundin e shekullit XVIII dhe përpjekjet e borgjezisë liberale për të kanalizuar vullnetin nacional dhe qytetar në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Ato kanë ndihmuar në diferencimin në mes të aspektit të vendimmarrjes publike që ka të bëj me mbledhjen e informacionit dhe atij që i referohet gjykimit (vendimit) politik: institucionet dhe agjencitë e pavarura luajnë rolin e gjeneruesve (prodhuesve) të informacionit, analizu-

[374] Kjo ka qenë përpjekje e kahershme e mendimit kushtetues perëndimor. Në vijim të kësaj përpjekjeje, tipologjinë e formave të neutralizimit të pushtetit askush më mire nuk e ka bërë se **Karl Shmit**, në një shkrim të tij, të botuar para debatit famoz me **Hans Kelsen**-in. Cf. Sandrine Baume, "De l' usage des pouvoirs neutres", fq. 17-27 (punimi i Karl Shmit citohet në fq. 18, fusnota nr. 6).Në këtë shkrim, **K. Shmit** i jep dy kuptime të mëdha të neutralitetit të pushtetit. I pari është **kuptim pasiv i neutralitetit**, ku nuk kërkohet ndërhyrja, arbitrimi apo vendimi i një organi për të siguruar balancimin (ekuilibrimin) e pushteteve. I dyti, ndërkaq, është **kuptimi aktiv i neutralitetit**, sipas të cilit kërkohet ndërhyrja, arbitrimi apo vendimi i një organi me qellim të sigurimit të balancimit (ekuilibrimit) të pushteteve. Në kuptimin aktiv të neutralitetit, gjithnjë sipas **K. Shmit**, ekzistojnë katër forma të manifestimit të tij. Në rend të parë, në këtë kategori hyn neutraliteti aktiv i kuptuar si pavarësi dhe paanësi që bazohet në një normë apo në një kuadër legal që ekziston paraprakisht. I tillë është rasti me neutralitetin e gjyqtarëve: vendimi i një gjyqtari nuk ka asnjë ngjyrim politik.Në kundërshtim me këtë, **Hans Kelsen** vendimmarrjes në gjykatë kushtetuese ia njeh një cilësi gjysmëpolitike. Në kategorinë e dytë, gjithnjë sipas kategorizimit të **K. Shmit**-it të llojeve të neutralitetit aktiv hyn neutraliteti që bazohet në një kompetencë të ngushtë profesionale të zhveshur nga interesa egoiste. Më këtë, **Shmit** nënkupton vendimmarrjen që bazohet në ekspertizën e ekspertit të fushës përkatëse (dije teknike). Kategoria e tretë, e cila lidhet me pozitën dhe rolin kushtetues të shefit të shtetit në **Gjermaninë e Vajmarit**, përfshinë neutralitetin që është shprehje e një tërësie dhe uniteti në të cilin ngërthehen dhe shpërthehen të gjithë antagonizmat grupor (parcial), duke u relativizuar deri në atë shkallë (masë) sa bëhet e njëjtë me vendimmarrjen e organit të krijuar për të siguruar balancimin (ekuilibrimin) e pushteteve. Ky neutralitet është neutralitet i vendimit shtetëror, i cili, në ndeshje me fërkimet partiake dhe ndarjet e veçanta në shtet, i shtypë konfliktet dhe dallimet brenda-shtetërore sepse ky vendim përfaqëson interesin shtetëror dhe totalitetin. Ky është neutraliteti i presidentit dhe vendimmarrjes se tij.

esit të provave dhe gjendjes faktike dhe, përmes mekanizmave të adresimit të padrejtësive, ndërtuesit të proceseve për kontrollim të vendimeve politike sipas standardeve të racionalitetit dhe proporcionalitetit. Kjo nënkupton se vendimmarrja politike ngushtohet deri në atë masë sa që gjykimi politik shndërrohet në një **zgjidhje teknokratike të problemeve**, në të njëjtën kohë që qartësohet përgjegjësia e institucioneve kushtetuese përfaqësuese për të artikuluar parimet dhe vlerat që përcaktojnë vendimet politike.

Institucionet dhe agjencitë e pavarura vlerësohen mjaft në botën bashkëkohore për arsye se përfaqësojnë komunitete epistemologjike, puna e të cilave tejkalon ndarjen në mes të sferës publike dhe sferës private dhe, marrë parasysh detyrat e tyre qartazi të specializuara, gjenden në një pozitë më të mirë për të ofruar informacionin dhe dëshmitë më të mira për të faktuar çështjet që adresohen. Përveç kësaj, duke qenë të pavarura dhe institucione të përbëra prej ekspertëve, **agjencitë dhe institucionet e pavarura** gjenerojnë besim më të madh për të qenë bartës të njohurive të sakta dhe të qëndrueshme. Ato ndihmojnë legjislativin në dizajnin legjislativ, kurse ekzekutivin në miratimin e normativës dhe standardeve të sjelljes të bazuara në gjendjen faktike të provueshme në praktikë. Kjo e fundit flet shumë për zgjerimin e mekanizmave të policimit dhe mbikëqyrjes në adresimin e çështjeve kryesore të qeverisjes: rregullat fiskale që miratojnë institucionet dhe agjencitë e pavarura disiplinojnë ministrat, politikat monetare që miratojnë bankat qendrore shtrëngojnë dhe kufizojnë qeveritë, rregullativat e auditimit strukturojnë programet e trupave publike dhe, së fundi, përcjellja e performacës përmes mekanizmave të autoriteteve të pavarura strukturojnë mënyrat sipas së cilave pushteti kryen përgjegjësitë që ka. E thënë me fjalë të tjera, **autoritetet e pavarura rregullative** sqarojnë gjykimin politik përmes imponimit të disiplinës së rreptë ndaj procesit të vendimmarrjes, gjë që ndikon në vetë **natyrën e ndarjes së pushteteve.**

Njëra ndër premisat themelore në lidhje me pushtetin është se ai rritet përmes imponimit të kufizimeve. Kjo temë haset qysh në analizën klasike të **Zhan Bodin (**Jean Bodin: 1530-1596) ”Forma më e mirë e bashkësisë politike”, thoshte **Bodin**, “është ajo në të cilin monarku mban atë që i takon, Senati autoritetin e vet, zyrtarët shtetërorë ekzekutojnë pushtetin e dy të parëve, kurse drejtësia vazhdon rrugën e saj të zakonshme”.[375] Esenca e kësaj teze është se një shtet i mirë ekziston atëherë kur institucionet e qeverisjes qëndrojnë pranë detyrave që kanë dhe nuk invadojnë sferën e kompetencave të të tjerëve. Me rritjen e aparatit të pushtetit në shkallë e kompleksitet, parimi i **Bodin** si më sipër, që thotë se pushteti rritet përmes evoluimit të **diferencimit institucional**, ka vazhduar të bëj punën e vet. Ky parim në fillim ka pasur për qëllim të krijoj një kuadër institucional që fuqizon qeverisjen monarkike, kurse rëndësia e tij është transformuar me ngritjen e demokracisë. Sot ai shprehet më së shpeshti përmes doktrinës mbi **ndarjen e pushteteve**. Kjo doktrinë, sikundër dihet, pretendon se pushteti shtetëror mund të pajtohet me **lirinë individuale** përmes metodës së alokimit të tri funksioneve kryesore të qeverisjes-bërja e normave, ekzekutimi i normave dhe gjykimin sipas normave- institucioneve të ndryshme që, më pastaj, ato të jenë në gjendje të kontrollojnë veprimet e njëra tjetrës. Siç është e ditur, megjithatë, rritja e pushtetit administrativ, që nga fundi i shek. XVIII e në veçanti pas gjysmës së dytë të shekullit në vijim, rrezikon të debalancoj jo vetëm veprimin e parimit mbi **ndarjen e pushteteve** por edhe ta bëj atë **anakronik**. Janë disa arsye që flasin për një rrezik të tillë.

Zhvillimi i institucioneve dhe agjencive të pavarura ka intensifikuar rrezikun që paraqet rritja e pushtetit administrativ, pushtet që ka pasur manifestimet e para me lindjen e **shtetit policor**, të përshkruar më sipër. Ato tregojnë për rrënjosjen e thellë të pushtetit të **elitave** që nuk janë të zgjedhura (nuk kanë dalë nga zgjedhjet e lira), për të ndikuar në pushtet, në ndërkohë që e përjashtojnë veten nga procesi i përgjegjësisë demokratike. Për nga natyra e vërtetë e tyre, ekziston frika që institucionet dhe agjencitë e pavarura përfaqësojnë **degën e katërt të pushtetit** që po lind e vepron në pajtim më parimin e **Zh. Bodin**. Ky lloj i ri i pushtetit përforcon kulturën e shmangies së fajësisë, në të njëjtën kohë fuqizon

[375] Jean Bodin, *The Six Bookes of a Commonweale.* Richard Knolles (trans) [1606] Kenneth Douglas McRae (ed) (Cambridge, MA: Harvard University Press, 1962) fq. 518.

kapacitetin e pushtetit për të marrë njohuri të specializuar, që sot është kusht i domosdoshëm dhe thelbësor për qeverisje efektive. Për këtë arsye, autoritet e pavarura e fuqizojnë demokracinë. Këtë e bëjnë përmes ndërtimit të një kuadri institucional që mundëson bërjen e dallimit të qartë në mes të gjykimeve profesionale që bazohen në dije të specializuar dhe gjykimeve politike që mbështetet në vlera e parime abstrakte. Të kuptuara kësisoj, **autoritetet e pavarura rregullative** janë larg prishjes së parimit mbi ndarjen e pushteteve. Ato veprojnë për të ndriçuar kufijtë në mes të detyrave kryesore të institucioneve primare kushtetuese të pushtetit shtetëror. Në këtë kuptim, ato janë entitete që **riforcojnë demokracinë**. Kjo është kështu edhe për faktin se vetë **demokracia përfaqësuese**, në origjinën e vet dhe aktualisht, përfaqëson një koncept **elitist** të demokracisë: ngritja e autoriteteve të pavarura përmbysë njërin prej supozimeve kryesore të demokracisë përfaqësuese, që thotë se populli e ka më mirë nëse delegon gjykimin dhe vendimmarrjen te përfaqësuesit e zgjedhur, nisur nga ajo se këta të fundit janë më mirë të informuar dhe komandojnë më shumë dije sesa populli apo qytetari i zakonshëm. Te autoritetet e pavarura kjo premisë përmbyset, ashtu që, në këtë ”ndarje të re të pushtetit” apo në këtë ”pushtet të katërt”, përfaqësuesit e zgjedhur më nuk janë në pozitë të pretendojnë qasje të privilegjuar në informata, sepse ato tani gjenden në duart e institucioneve dhe agjencive të pavarura. Përveç kësaj, qytetarët dhe popullsia, në të shumtën e kohës, nuk i beson informatave të gjeneruara nga pushteti: tani ata mbështeten në burimet e informatave që nuk janë të përlyera nga makineria e pushtetit. Në këtë kuptim, ngritja dhe fuqizimi i **autoriteteve të pavarura rregullative** vjen si pasojë e rënies së elektoratit të dëgjueshëm. Duke mbledhur dhe shpërndarë informacion profesional dhe të specializuar dhe duke analizuar faktet, autoritetet e tilla luajnë një rol të rëndësishëm në fuqizimin e qeverisë demokratike.

Një faktor tjetër që ka çuar në rritjen e autoriteteve të pavarura nuk ka fare të bëj me nivelin nacional të qeverisjes, por me faktorin ndërkombëtar. Trendët integrative në nivel të regjioneve të ndryshme të botës, në veçanti në Evropë, kanë bërë që të rriten agjencitë dhe institucionet rregullative për të adresuar problemet që tejkalojnë kufijtë nacional. Kjo ka të bëjë me të gjitha sferat e jetës shoqërore, ekonomike, politike, bashkëpunimit ndërkombëtar në sferën e drejtësisë dhe policisë, kulturës, sportit dhe kështu me radhë. Mjafton këtu të përmendim **Bankën Qendrore Evropiane**, institucionet si **Eurpol**, **Eurojust** etj., pastaj rastin e ekzekutimit të urdhrave për arrest në Evropë për veprat e terrorizmit ndërkombëtar nga ana e agjencive nacionale ligjzbatuese, si dhe shumë agjenci e institucione të tjera të specializuara që nuk janë pjesë e ndarjes tripartite të pushtetit në nivel nacional. Në fakt, në literaturë, Evropa dhe institucioni i saj kryesor, **BE**, janë cilësuar si ”shteti i rregullativës”, për të treguar aktivitetin e madh rregullativ që luan BE përmes agjencive dhe institucioneve të saj. Afërisht me të njëjtin qëllim, sot ekzistojnë edhe në nivel ndërkombëtar agjenci e institucione të specializuara në të cilat shtete sovrane i kanë bartur disa prej funksioneve e kompetencave të tyre kushtetuese, me qëllim të realizimit të tyre në planin ndërkombëtar.[376]

Për të realizuar këtë potencial të forcimit të demokracisë mbi bazë të dijes së specializuar, **agjencitë dhe institucionet e specializuara** duhet të pretendojnë një autoritet origjinal, jo të deleguar, përkatësisht një **pozitë të garantuar kushtetuese** brenda sistemit të konfiguracionit të institucioneve të sistemit kushtetues. Në të shumtën e rasteve, pozita e tyre kushtetuese arsyetohet ashtu që ato trajtohen si diçka që buron nga autoriteti i institucioneve përfaqësuese. Këto pikëpamje, megjithatë, pak janë të besueshme dhe teorikisht të gabuara:[377] ato fitojnë legjitimitetin nga **modus operandi** që ndjekin, i cili bazohet në dije profesionale e të specializuar, që fitohet në bazë të rregullave të ekspertizës dhe profesionit. Ai informacion që gjenerohet mbi këtë bazë shërben për të promovuar përgjegjësinë e degëve të tjera të pushtetit shtetëror: autoritetet e pavarura ushqejnë proceset e vendimmarrjes dhe punën e pushteteve të tjera me informata të fituara përmes përdorimit të mjeteve dhe metodave shkencërisht të dëshmuara. Kjo i hap rrugë të reja përgjegjshmërisë gjatë ushtrimit të pushtetit shtetëror. Përveç kësaj, ato janë një autoritet publik i dallueshëm nga pushtetet tjera tradicionale edhe për shkak se vetë i përcaktojnë

[376] András Sajó, “Les autorités indépendantes”, fq. 331-333.

[377] Frank Vibert, *The Rise of the Unelected: Democracy and the New Separation of Powers* (Cambridge University Press: Cambridge, 2007) fq. 15.

procedurat e tyre për vërtetimin e fakteve-procedura që janë të ndryshme nga procedurat parlamentare, metodat burokratike të administratës apo procesi juridik-gjyqësor.

Në kuadër të **modus operandi** si bazë e autoritetit të institucioneve dhe agjencive të pavarura hyn edhe aftësia e tyre për të instaluar **koordinimin dhe disiplinën** në procesin e qeverisjes bashkëkohore. Ngritja e tyre sinjalizon për nevojën e plotësimit të sistemit të së drejtës administrative bashkëkohore me një lloj të ri të renditjes institucionale, që është e orientuar edhe më hapur kah logjika e policimit (disiplinimit), si qasje që dallon shumë nga logjika juridike. Në këtë mënyrë, **agjencitë dhe institucionet e pavarura** në njëfarë mënyrë përfaqësojnë "shkallën e katërt të pushtetit", që qëndron në raport të ngjashëm me pushtetin e policimit (disciplinimit), siç qëndron gjyqësori në raport me kushtetutat moderne. Kjo do të thotë, thënë me fjalë të tjera, se **autoritet e pavarura rregullative** janë po aq të saktësuara dhe garantuara me kushtetutë sa edhe gjyqësori, që zakonisht normohet me kushtetutë në nivel parimi dhe, në kuptimin institucional, vetëm sa i përket kupolës së tij-gjykatës më të lartë në nivel nacional.

Në një analizë më radikale, ndryshimet e fundit në pushtetin shtetëror pas fuqizimit të këtyre agjencive dhe institucioneve rezulton në trajtimin si të tejkaluar të ngrehinës së konstitucionalizmit bashkëkohor dhe doktrinës së tij mbi ndarjen **triadie** të pushtetit shtetëror në pushtet legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Kjo ndarje **triadike**, në këtë analizë radikale, duhet të harrohet dhe të zëvendësohet më një imazh alternativ të pushtetit shtetëror, në të cilin pushteti paraqitet si një **rrjet**. Pionier i këtij qëndrimi është politologu amerikan **Edvard L. Rubin** (Edward L. Rubin), që ka argumentuar se rrjeti është një tërësi e lidhjeve në mes të nyjeve të posaçme, që shërbejnë për të transmetuar energji ose informacion, duke refuzuar konceptin tradicional **triadik** si një pengesë për kuptimin e esencës së pushtetit shtetëror. Analiza me formë rrjeti mundëson që drejtpërdrejtë të ndeshen sfidat institucionale të qeverisjes bashkëkohore. Metafora e pushtetit triadik, që shpërfaq parimin e ndarjes e pushtetit, bazohet në një model të vjetruar të pushtetit të kufizuar dhe ofron një kuadër të varfër konceptual për kuptimin e proceseve bashkëkohore dhe peizazhit të tyre kushtetues.[378] Ngritja e **aparatit administrativ** të shtetit e ka zhveshur aftësinë e skemës **triadike** të pushtetit shtetëror për të kapur dinamikat komplekse të pushtetit bashkëkohor. Problemi që sot shtrohet ka të bëj me atë se "pushteti shtetëror do të bëhet ose joefektiv ose shtypës, struktura e tij masive dhe stabile do të bëhet shumë e vetëpërmbajtur pa u përpjekur për nevojat e popullit, të cilin ose do ta injoroj ose do ta shtypë".[379] Në natyrën e sistemeve politike në dy anët e Atlantikut, përgjatë shekullit XX ka ardhur deri te një ndryshim rrënjësor në natyrën e strukturës së pushtetit, e cila ka pësuar një ndryshim fundamental: strukturat administrative të shtetit janë zhvilluar deri në atë masë, saqë ndikimi i tyre në jetën e qytetarëve të zakonshëm u bë shumë më i madh dhe potencialisht shumë më represiv sesa kishte qenë veprimi i pushtetit triadik klasik në të kaluarën.

Pikërisht për shkak të këtyre rreziqeve nga pushteti shtetëror kanë lindur dhe janë zhvilluar **agjencitë dhe institucionet administrative**, me qëllim të menaxhimit të proceseve shoqërore duke ngarkuar politikbërësit e zgjedhur dhe gjyqtarët e orientuar doktrinarisht me detyrën e monitorimit të tyre.[380] Tani problemi i funksionimit të pushtetit shtetëror bashkëkohor nuk mund të shpjegohet nëse mbështetemi te ndarja **traidike**. Vetëm duke u parë ligjvënësi, ekzekutivi dhe gjyqësori si një tërësi e angazhuar në ndërmarrjen e përbashkët, e cila konsiston në kontrollin e aparatit shtetëror administrativ, mund të kuptohet esenca e pushtetit në shtetin bashkëkohor, ku autoritetet e pavarura rregullative luajnë një rol jo pak të rëndësishëm. Për këtë arsye, metafora e rrjetit ofron një pasqyrë më të qartë sepse kap tërësinë dhe esencën e problemit. Kjo metaforë, metafora e **rrjetit**, jo **hierarkia** e organeve që vlen te pushteti triadik (në fakt, **autoritetet e pavarura rregullative** nuk janë në raport hierarkik me asnjërin prej tri pushteteve), gjeneron mikroanalizën e pushtetit shtetëror që rezulton në përqafim më të lehtë të ekzis-

[378] Edward L Rubin, *Beyond Camelot: Rethinking Politics and Law for the Modern State* (Princeton University Press: Princeton, NJ, 2005) fq. 48.
[379] Edward L Rubin, *Beyond Camelot: Rethinking Politics and Law for the Modern State* (Princeton University Press: Princeton, NJ, 2005), fq. 73.
[380] Ibid., fq. 73.

tencës e tij, të operacioneve komplekse pushtetore dhe prodhon ide praktike kreative për përmirësim të mëtejmë të funksionimit të makinerisë së pushtetit.[381] Kjo qasje, duket qartë, më shumë përkon me realitetin dhe e reflekton tërë kompleksitetin e peizazhit kushtetues të vendeve demokratike bashkëkohore. Kjo qasje shpjegon më së miri edhe vetë ***raison d'être*** të lindjes së tyre dhe qëllimin të cilit i shërbejnë: ato kanë lindur, historikisht shikuar, si pasoje e rritjes se nevojave të shtetit modern për rregullim të shpejtë të jetës dhe aktiviteteve të tjera shtetërore dhe me qëllim të ruajtjes së individit dhe lirisë së tij. Për këtë arsye, vendet e Evropës me kohë kanë ndërtuar rregullativa administrative të nivelit evropian kurse në planin ndërkombëtar përpjekjet e shteteve kaherë kanë qenë për të adresuar globalisht aspektet të ndryshme të jetës shoqërore që iu përkasin shteteve sovrane. Në të njëjtën kohë, autoritete e pavarura shërbejnë si mënyre mjaft specifike e neutralizimit te pushtetit shtetëror në planin e brendshëm, regjional dhe ndërkombëtar. Ky specificitet shprehet në rend të parë në **modus operandi** të këtyre agjencive dhe institucioneve të pavarura administrative dhe në funksionet dhe punët që kryejnë.[382]

Sa i përket rolit dhe pozitës së tyre kushtetuese, **autoritetet e pavarura rregullative** vështirë se mund të kategorizohen në ndonjërin prej organeve qendrore kushtetuese. Në grupin e fundit hyjnë organet shtetërore që janë refleksion i drejtpërdrejtë i sovranitetit shtetëror dhe zënë pozitën e autonomisë së kualifikuar, sepse nuk njohin asnjë organ tjetër superior mbi vetveten, konsiderohen pushtet shtetëror në kuptimin e ngushtë e të plotë të fjalës, marrin pjesë në mënyra të ndryshme në realizimin dhe ushtrimin e funksionit politik të shtetit, përkatësisht marrin pjesë drejtpërdrejtë në individualizimin e qëllimeve që shteti ia ka vënë vetes dhe synon t'i realizoj. Këtë cilësi e kanë vetëm organet që rezultojnë nga ushtrimi i drejtpërdrejtë i sovranitetit, që përkthehet në norma kushtetuese dhe trajta institucionale të realizimit të tij të drejtpërdrejtë. Këto trajta institucionale, përkatësisht organe kryesore kushtetuese i cakton në mënyrë të drejtpërdrejtë kushtetutëbërësi: ato në mënyrë të caktuar shprehin normën e kushtetutës. Të tilla janë organet qendrore që me kushtetutë vishen me funksion legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor në nivel nacional. Funksionet dhe kompetencat e tyre janë te përcaktuara me vetë kushtetutën e vendit.

Autoritet e pavarura rregullative nuk mund të hyjnë as në organet e themeluara me ligj dhe akte të tjera nënligjore, sepse jo rrallë ato garantohen me kushtetutë, e cila ua përcakton qartë kuadrin kushtetues të themelimin dhe fizionominë, në rend të parë përmes përcaktimit të juridiksionit bazë, duke lënë me ligj operacionalizimin e mëtejmë të dimensioneve kushtetuese. Në këtë kuptim, pra kur përcaktohen me kushtetutë, pa asnjë dyshim, ato janë **entitete me rëndësi kushtetuese**. Me kategorinë e organeve shtetërore të themeluara me ligj dhe akte të tjera nënligjore, megjithatë, **agjencitë dhe institucionet e pavarura** kanë ngjashmëri sa i përket një dimensioni: ato nuk marrin pjesë në funksionin politik të shtetit, në realizimin e sovranitetit shtetëror. Në këtë kuptim, thënë kushtimisht, ato mund të futen në grupin e dytë të organeve, por jo si organe shtetërore por si autoritete të pavarura, pikërisht për shkak se nuk marrin pjesë në funksionin politik të shtetit dhe kanë, në të njëjtën kohë, një rëndësi esenciale për strukturën kushtetuese të shtetit. Veprimtarinë e tyre më së shpeshti e përcakton ligjvënësi, mirëpo normimi i tyre kushtetues çdo ditë e më shumë po bëhet fenomen i përhapur si pasojë e rëndësisë së veprimtarisë që kryejnë, duke u cilësuar kësisoj si entitete kushtetuese **sui generis**.[383] Krahas pjesëmarrjes në këtë grup, **autoritetet e pavarura** shpërfaqin edhe disa cilësi të tjera që janë krejt të përbashkëta për të gjitha llojet e tyre. Në rend të parë, ato kanë natyrë jodemokratike, ekzekutive dhe vendimmarrëse. Krahas kësaj, së dyti, veprimtaria e tyre është thellësisht, dhe pa asnjë përjashtim, profesionale dhe specializuar. Në këtë aspekt, ato i takojnë **makinerisë administrative të**

[381] Edward L Rubin, *Beyond Camelot: Rethinking Politics and Law for the Modern State* (Princeton University Press: Princeton, NJ, 2005), fq. 73.

[382] Cf. më shumë për qasjet në nivel nacional, evropian dhe ndërkombëtar ndaj fuqisë rregullative të shtetit, në punimet si vijon: Fabrizio Gilardi, "Policy credibility and delegation to independent regulatory agencies: a comparative empirical analysis". *Journal of European Public Policy* Vol. 9 No. 6 (2002) fq. 873-893; Mark Catcher, "Regulation after delegation: independent regulatory agencies in Europe". *Journal of European Public Policy* Vol. 9 No. 6 (2002) fq. 954-972.

[383] András Sajó, "Les autorités indépendantes", fq. 324.

shtetit bashkëkohor dhe, pa asnjë dyshim, nuk mund të klasifikohen në **ndarjen triadike** klasike të pushtetit shtetëror në pushtet legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Tanimë nuk bëhet fjalë për kontroll dhe baraspeshë të tri pushteteve klasike, por për koordinim të makinerisë së pushtetit, që ka marrë përsipër kryerjen e punëve dhe ushtrimin e funksioneve publike për të përballuar kërkesat dhe nevojat e **shtetit social** që u fuqizua përgjatë shekullit XX në përmasa marramendëse.[384]

Për nga shtrirja e tyre, ato janë pjesë e një **rrjeti** të përgjithshëm të strukturave administrative të shtetit bashkëkohor, vertikalisht të pozicionuara në peizazhin kushtetues. Në fizionominë e jashtme, ndërkaq, ato shpërfaqin tiparet e veprimtarisë ekzekutive, që nuk bazohet në racionalitetin dhe oportunitetin politik, por në ekspertizë e specializim të ngushtë profesional si një **modus operandi** konstant i tyre. Mbi bazën e këtyre dy cilësive, pozicionimit horizontal dhe **modus operandi**, ndërtohet ideja bashkëkohore e **pavarësisë personale, financiare** dhe institucionale të këtyre strukturave administrative nga kontrolli i ekzekutivit dhe lidershipit politik. Aty ku normohen me kushtetutë, zakonisht përfshihet aspekti i autonomisë dhe pavarësisë personale sa i përket titullarit dhe përbërjes së tyre, kurse pavarësia financiare dhe institucionale i lihet në duar ligjvënësit nacional. Këtu përfshihet edhe mbikëqyrja e punës së tyre, që zakonisht i lihet ligjvënësit, kurse gjyqësorit mbikëqyrja e ligjshmërisë së punës së tyre. Ekzekutivi ka shumë pak ndikim, përveç në stafimin e personelit kyç të autoriteteve të pavarura dhe këtu zakonisht vjen në shprehje politizimi i tyre.

Në kontekstin e politizimit të autoriteteve të pavarura rregullative, në literaturë është vërejtur se, në sistemet parlamentare mjaft shpesh vjen deri te caktimi partizan i anëtarëve të tyre, përveç **Britanisë së Madhe**, e cila ka një rekord shumë pozitiv të emërimit të ekspertëve dhe profesionistëve në strukturat udhëheqëse të autoriteteve të pavarura. Kjo nuk është kështu në vendet tjera të Evropës, ku është vërejtur një tendencë për politizimin e tyre. Kjo zakonisht bëhet duke shkelur rregullat mbi konfliktin e interesit me rastin e caktimit të anëtarëve të autoriteteve të pavarura rregullative. **Konflikti i interesit** zgjatë edhe pas mbarimit të mandatit të anëtarëve të autoriteteve të pavarura, ashtu që ndalohet punësimi i anëtarëve të tillë pas mbarimit të mandatit në sektorët apo institucionet që kanë qenë objekt i rregullimit nga ana e autoritetit të pavarur. Caktimi i anëtarëve në baza partizane, ndërkaq, përbën rastin më të shpeshtë të shkeljes së rregullave mbi **konfliktin e interesit**. Kështu, ta zëmë, në periudhën në mes të viteve 1990-2001, në Francë 46% e nominimeve të anëtarëve të autoriteteve të pavarura rregullative ka qenë në baza politike partizane, në Gjermani 36%, në Itali 77%. Nuk ka rëndësi fakti që në këto vende është provuar se nominimet e anëtarëve partizan kanë poseduar një kompetencë të kënaqshme profesionale.[385]

Çështja që provokon konteste kushtetuese më së shpeshti ka të bëj me nominimin dhe shkarkimin e anëtarëve të autoriteteve të pavarura rregullative. Kjo bëhet për shkak se rrallë herë dispozitat kushtetuese janë të qarta, kurse infrastruktura ligjore ngelet shpesh herë e heshtur për njërin prej dy dimensioneve si më sipër, përkatësisht sa i përket nominimit ose shkarkimit. Këto janë aspekte me rëndësi për pavarësinë e tyre, nëse jo aspektet e tyre kyçe. Në këtë kuptim, garancioni i pavarësisë së autoriteteve të pavarura rregullative ndryshon nga një vend në tjetrin. Ato më së shpeshti në krye të tyre kanë një organizëm kolektiv, ani pse mjaft shpesh hasim në drejtimin individual të tyre, në veçanti në domenin e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut. Pjesëmarrja e shumë organeve **në procesin e nominimit të tyre**, më së shpeshti lajmërohet si një garancion për pavarësinë e tyre, sesa kur kjo bëhet me dominimin e një organi, partie ose grupi të interesit. Në mesin e masave të tjera që garantojnë pavarësinë e tyre vlen të përmendet pjesëmarrja e gjyqtarëve dhe profesionistëve të tjerë që caktohen nga organizmat profesionalë, ashtu që krijohet një autoseleksion i anëtareve të autoritetit rregullativ. Në rastet kur bëhet fjalë për përbërje kolegjiale, mandati i shpërndarë nëpër kohë i anëtarëve të autoritete paraqitet si një garanci, për shkak se zvogëlon mundësinë e dominimit nga

384 M. J. C. Vile, *Constitutionalism and the Separation of Powers*, fq. 405-406.
385 András Sajó, "Les autorités indépendantes", fq. 335.

politika e ditës së përbërjes së autoritetit të pavarur rregullativ. Mandati i përcaktuar, pa mundësi rinominimi gjithashtu paraqitet si një garancion tjetër i pavarësisë së tyre. Nuk është i parëndësishëm, nëse jo tepër i rëndësishëm, ndalimi i qartë i revokimit apo shkarkimit të anëtarit të autoritetit pa saktësuar qartë me norma shkaqet dhe rrethanat për një gjë të tillë. Në këtë mes, përcaktimi i procedurave të komplikuara, që kërkojnë votim të kualifikuar apo me kundërfirmë të dy ose më shumë organeve shtetërore nominuese, përbën garancion të rëndësishëm. Qartësimi i konfliktit të interesit, siç u pa më sipër, përbën një rrethanë që dëmton pavarësinë e autoritetit rregullativ. Kjo më së miri shihet në rastin amerikan, ku ka pasur akuza për shkelje të pavarësisë dhe integritetit të autoriteteve të pavarura rregullative pasi disa anëtar të tyre pas mbarimit të mandatit janë punësuar në firmat që kanë qenë objekt rregullimi i tyre.[386]

38.1. Agjencitë dhe institucionet e pavarura në Kosovë

KKos flet për institucionet dhe agjencitë e pavarura në kapitullin XII (nenet 132-142) dhe i ndan ato në institucione dhe agjenci të pavarura. Në grupin e parë hyjnë: **Avokati Popullit** (AP), **Auditori Përgjithshëm** (AupKos), **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** (KQZ), **Banka Qendrore** (BQ) dhe **Komisioni i Pavarur i Medieve** (KPM). Në grupin e dytë, ndërkaq, hyjnë krejt ato institucione që themelohen nga Kuvendi.

Me nenin 132 rregullohen roli dhe kompetencat e **AP**. Ky organ mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike (neni 132.1 i **KKos**). Është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtetin në Republikën e Kosovës (neni 132.2 i **KKos**). Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të AP dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj (neni 132.3 i **KKos**). AP ka një zyrë, fizionomia e së cilës përcaktohet me nenin 133 të KKos. Zyra e Avokatit të Popullit është e pavarur, dhe propozon e administron buxhetin e vet, në pajtim me ligj (neni 133.1 i **KKos**). AP ka një (1) ose më shumë zëvendës. Numri, mënyra e përzgjedhjes dhe mandati i tyre, rregullohen me ligjin për AP. Të paktën një (1) nga zëvendësit e AP është pjesëtar i komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.
AP e zgjedh Kuvendi i Kosovës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të tij, për një mandat pesë (5) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje (neni 134.1 i **KKos**). Ajo/ai ka të drejtë të zgjidhet çdo shtetas i Republikës së Kosovës, me arsim të lartë, me karakter e moral të lartë, i ndershëm, me eksperiencë dhe njohuri të dalluara në fushën e të drejtave të njeriut (neni 134.2 i **KKos**). AP dhe zëvendësit e saj/tij nuk mund të jenë anëtarë të asnjë partie politike, as të ushtrojnë veprimtari politike, shtetërore a private profesionale dhe as të marrin pjesë në organizmat drejtues të organizatave civile, ekonomike dhe tregtare (neni 134.3 i **KKos**). Gëzon imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimet ose vendimet që janë brenda fushës së përgjegjësive të saj/tij (neni 134.4 i **KKos**) dhe mund të shkarkohet vetëm me kërkesën e më shumë se një të tretës (1/3) së të gjithë deputetëve, dhe në këtë rast Kuvendi vendos me shumicën e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të tij (neni 135.5 i **KKos**).

AP-ja paraqet raport vjetor para Kuvendit të Republikës së Kosovës (neni 135.1 i **KKos**). Me kërkesën e Kuvendit, ajo/ai duhet të dorëzojë raporte periodike ose të tjera Kuvendit. Me kërkesën e Avokatit të Popullit, Kuvendi duhet t'ia lejojë që të dëgjohet (neni 135.2 i **KKos**). Ajo/ai ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore (neni 135.3 i **KKos**). Ka të drejtë të referojë çështje në **GJKRKS**, në pajtim me dispozitat e KKos (neni 135.4 i **KKos**).

386 András Sajó, "Les autorités indépendantes", fq. 340.

AupKos është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar (neni 136.1 i **KKos**). Organizimi, funksionimi dhe kompetencat e këtij organi përcaktohen me KKos dhe me ligj (neni 136.2 i **KKos**). AupKos zgjedhet nga Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, në bazë të propozimit të Presidentit të Republikës së Kosovës (neni 136.3 i **KKos**). Kuvendi vendos për shkarkimin e **AupKos** me shumicën e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të tij, në bazë të propozimit të presidentit ose me nismën e një të tretës (1/3) së deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës (neni 136.4 i **KKos**). Mandati i saj/tij është pesë (5) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm edhe për një mandat (neni 136.5 i **KKos**). **AupKos** ka këto kompetenca: 1. Kontrollon veprimtarinë ekonomike të institucioneve publike dhe të personave të tjerë juridikë shtetërorë; 2. Kontrollon përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve publike nga organet e pushtetit qendror dhe lokal; 3. Kontrollon veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve publike dhe personave juridikë të tjerë, tek të cilët shteti ka një pjesë të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti (neni 137 i **KKos**). **AupKos**, Kuvendit i paraqet: 1. Raport për zbatimin e buxhetit të Shtetit; 2. Mendimin për raportin e qeverisë për shpenzimet e vitit financiar të shkuar, para se të miratohet nga Kuvendi; 3. Informacione për rezultatet e kontrolleve, sa herë që kërkohet nga Kuvendi (neni 138.1 i **KKos**). **AupKos** i paraqet Kuvendit raportin vjetor për veprimtarinë e vet (neni 138.2 i **KKos**).

KQZ-ja është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve e referendumet dhe shpall rezultatet e tyre (neni 139.1 i **KKos**). Përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë neni 139.2 i **KKos**). Kryesuesin e tij e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të GJSKos dhe të gjykatave me juridiksion apeli (neni 139.3 i **KKos**). Gjashtë (6) anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara. Nëse në Kuvend janë të përfaqësuara më pak grupe, grupi a grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë. Një (1) anëtarë emërohet nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin serb të Kosovës dhe tre (3) anëtarë nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë (neni 139.4 i **KKos**).

BQ është institucion i pavarur i cili i përgjigjet vetëm Kuvendit të Kosovës (neni 140.1 i **KKos**) dhe ushtron kompetencat e pushtetin e vet vetëm në pajtim me KKos dhe instrumentet e tjera ligjore të zbatueshme (neni 140.2 i **KKos**). Guvernatori i BQ ushtron edhe detyrën e kryeshefit të saj ekzekutiv (neni 140.3 i **KKos**). Qeverisja e BQ dhe procedurat e zgjedhjes dhe të nominimit të anëtarëve të Bordit të BQ rregullohen me ligjin, cili duhet të sigurojë pavarësinë dhe autonominë e saj (neni 140.4 i **KKos**).

KPM është organ i pavarur që rregullon spektrin e Frekuencave Transmetuese në Republikën e Kosovës, licencon transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj (neni 141.1 i **KKos**). Anëtarët e tij zgjidhen sipas ligjit, përmes një procesi transparent (neni 141.2 i **KKos**).

Në fund të kapitullit dymbëdhjetë, në vetëm një nen, nenin 142, **KKos** rregullon rolin dhe pozitën e agjencive të pavarura, pa emërtuar ndonjërën prej tyre, duke lënë këtë në prerogativë të ligjvënësit kosovar. Agjencitë e pavarura janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Funksionet e tyre i kryejnë në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Kosovë (neni 142.1 i **KKos**), kanë buxhetin e tyre, i cili administrohet në mënyrë të pavarur, në pajtim me ligj (neni 142.2 i **KKos**). Secili organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Kosovë, është i detyruar të bashkëpunojë dhe t'u përgjigjet kërkesave të agjencive të pavarura gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore, në pajtim me ligj (neni 142.3 i **KKos**).

38.2. Agjencitë dhe institucionet e pavarura në Shqipëri

Institucionet e pavarura në **KShq** nuk gjenden në një vend, siç është rasti me **KKos**, por të shkapërderdhura nëpër disa pjesë e në kuadër të kapitujve të ndryshëm. Agjencitë, ndërkaq, as që zihen në gojë nga kushtetutëbërësi shqiptar, duke bërë të qartë se ajo përbën një rregullativë ligjore. Nga të gjitha institucionet e pavarura, në KShq figurojnë vetëm **Avokati Popullit** (APShq), **Banka Qendrore** (BQShq) dhe **Kontrolli i Lartë i Shtetit** (KLSH). Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZShq) më nuk përbën një kategori kushtetuese, siç do të shihet në vijim.

Në pjesën e dytë, kreu i gjashtë i KShq i dedikohet **APShq**. Ky institucion mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike (neni 160.1 i **KShq**). APShq është i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij (neni 160.2 i **KShq**), ka buxhet të veçantë, të cilin e administron vetë, dhe e propozon sipas ligjit (neni 160.3 i **KShq**). Ajo/ai zgjidhet nga tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për një periudhë prej 5 vjetësh, me të drejtë rizgjedhjeje (neni 161.1 i **KShq**). Titullar i APShq mund të jetë çdo shtetas shqiptar, me arsim të lartë, me njohuri dhe veprimtari të njohura në fushën e të drejtave të njeriut dhe të ligjit 9neni 161.2 i **KShq**). Ky titullar gëzon imunitetin e gjyqtarit të **GJLSH-së** (neni 161.3). APShq nuk mund të bëjë pjesë në asnjë parti politike, nuk mund të kryejë veprimtari tjetër politike, shtetërore ose profesionale dhe as të marrë pjesë në organizmat drejtues të organizatave shoqërore, ekonomike dhe tregtare (neni 161.4 i **KShq**).

Për shkarkimin e **APShq** përcaktohet një procedurë dhe disa kushtet shumë të vështira dhe të komplikuara, që sigurojnë një pavarësi të titullarit dhe vetë organit që drejton atë. APShq mund të shkarkohet vetëm me kërkesë të motivuar të jo më pak se një së tretës së deputetëve (neni 162.1 i **KShq**). Në këtë rast Kuvendi vendos me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të tij (neni 162.2 i **KShq**). Njëjtë si në rastin e Kosovës, **APShq** paraqet raport vjetor përpara Kuvendit (neni 163.1 i **KShq**). Përveç kësaj, ajo/ai raporton përpara Kuvendit kur i kërkohet prej këtij, si dhe mund t'i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme (neni 163.2 i **KShq**). Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike (neni 163.3 i **KShq**). Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin APShq të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij (neni 163.4 i **KShq**). Sikundër shihet, edhe dispozitat e fundit janë të ngjashme me ato të **KKos** dhe të kushtetutave të vendeve përreth Kosovës.

Në nëntor të vitit 1998, nëpërmjet një referendumi kombëtar, populli shqiptar aprovoi **KShq**, aktualisht në fuqi, e cila në nenet 153 dhe 154 sanksionoi krijimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZShq) si organ të përhershëm i përbërë nga shtatë anëtarë. Me miratimin nga Kuvendi i Shqipërisë të Ligjit nr. 8609, datë 08/05/2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", **KQZShq** mori formën e tij të plotë ligjore në nenet 16-31 të këtij kodi. Qershori i vitit 2000 shënon fillimin e aktivitetit të **KQZShq** me gjashtë anëtarë të emëruar sipas **KShq**, dy nga Presidenti i Republikës, tre nga KLD-ja dhe një nga Kuvendi. Një muaj më pas, në korrik të vitit 2000, Kuvendi emëroi anëtarin e shtatë të KQZ-së. Me Ligjin Nr.9675, datë 13 janar 2007, ndryshoi **KShq** dhe **KQZShq** nga shkurti i vitit 2007 përbëhet nga 9 anëtarë. Me Ligjin Nr.9904, date 21 prill 2008, KShq sërish ndryshoi. Këtë herë ndryshimi ishte më rrënjësor sepse shfuqizoi nenet 153 e 154 të pjesës së dymbëdhjetë të **KShq**, ku sanksionohej krijimi i **KQZShq**, duke ja lënë këtë prerogativë ligjvënësit shqiptar në formën e **Kodit Zgjedhor**: me Ligjin Nr.10019, datë 29 dhjetor 2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", u sanksionua krijimi i **KQZShq** si organi më i lartë shtetëror i përhershëm, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve, me 7 anëtarë, me mandat 4-vjeçar. Ky kod aktualisht është në fuqi. Anëtarët dhe kryetari i **KQZShq** zgjidhen nga Kuvendi i Shqipërisë.

Pjesa e trembëdhjetë e KShq rregullon financat publike të shtetit shqiptar. Brenda saj gjenden dispozitat për **BQShq**, fare në fund, në një nen të vetëm, i cili përcakton se "Banka Qendrore e shtetit është Banka e Shqipërisë. Ajo ka të drejtën ekskluzive të nxjerrjes e të qarkullimit të monedhës shqiptare, të zbatimit

të pavarur të politikës monetare dhe të mbajtjes e të administrimit të rezervave valutore të Republikës së Shqipërisë". (neni 161.1 i **KShq**). BQShq drejtohet nga një këshill, i cili kryesohet nga Guvernatori. Guvernatori zgjidhet nga Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës për 7 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje (neni 161.2 i **KShq**).

Në fund, në pjesën e katërmbëdhjetë, nenet 162-165 të KShq kanë të bëjnë me KLSH, i cili përshkruhet si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, që u nënshtrohet vetëm KShq dhe ligjeve (neni 162.1 i **KShq**). Kryetari i KLSH zgjidhet dhe shkarkohet nga Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës. Ajo/ai qëndron në detyrë për 7 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje (neni 162.2 i **KShq**). KLSH ka këto kompetenca: "a. kontrollon veprimtarinë ekonomike të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë shtetërorë; b. kontrollon përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shtetërore nga organet e pushtetit qendror dhe atij vendor; c. kontrollon veprimtarinë ekonomike të personave juridikë, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve ose të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti". (neni 163 i **KShq**). Për punën e vet, **KLSH-në** i paraqet Kuvendit: a) raport për zbatimin e buxhetit të shtetit; b) mendim për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar para se të miratohet nga Kuvendi; c) informacion për rezultatet e kontrolleve sa herë që kërkohet nga Kuvendi (neni 164.1 i **KShq**). KLSH-ja paraqet Kuvendit raportin vjetor të veprimtarisë së tij (neni 164.2 i **KShq**). Kryetari i **KLSH** mund të ftohet të marrë pjesë dhe të flasë në mbledhjet e Këshillit të Ministrave, kur shqyrtohen çështje që lidhen me funksionet e tij (neni 165.1 i **KShq**). Ajo/ai ka imunitetin e gjyqtarit të **GJLSH** (neni 165.2 i **KShq**).

38.3. Agjencitë dhe institucionet e pavarura në Maqedoninë e Veriut

As **KMVe** nuk ka një pjesë ose kapitull të veçantë për agjencitë dhe institucionet e pavarura. Në ndërkohë që të dytat i normon në mënyrë të shkapërderdhur, sikur **KShq**, të parat nuk i përmend fare, duke ia lënë këtë materie për rregullim ligjvënësit të vendit. Për më tepër, nga institucionet e pavarura, **KMVe** normon vetëm **Bankën Popullore** (BPMVe) dhe **Avokatin e Popullit** (APMve), në ndërkohë që për autoritetin e auditimit nuk thotë asnjë fjalë, siç nuk thotë as për komisionin qendror të zgjedhjeve. Këto dy institucione normohen me ligj dhe nuk kanë fizionomi kushtetuese, pra roli dhe pozita e tyre përcaktohet me ligj. Për këtë arsye ne flasim vetëm për ato institucione e agjenci që përcaktohen me kushtetutë, jo edhe ato që formohen me ligj sepse numri i tyre është i panumërt, gjë që tejkalon caqet dhe synimet e këtij libri.

Në pjesën e parë të **KMVe**, që normon liritë dhe të drejtat e njeriut, gjenden edhe dispozitat lidhur me institucionin e **BPMVe**, në kuadër të kapitullit të katërt që definon bazat e marrëdhënieve ekonomike. Aty **BPMVe** definohet si bankë e emisionit (neni 60.1 i **KMVe**). Ajo është e pavarur dhe mban përgjegjësi për stabilitetin e valutës, për politikën monetare dhe për likuiditetin e përgjithshëm të pagesave në Republikë dhe ndaj vendeve të jashtme (neni 60.2 i **KMVe**). Organizimi dhe puna e **BPMVe** rregullohen me ligj (neni 60.3 i **KMVe**).

Kushtetutëbërësi në **Maqedoninë e Veriut**, institucionin e **APMVe** fillimisht e ka normuar në nenin 77, pak më ndryshe se në amendamentet e mëpastajme. Në paragrafin e parë thuhej se atë e zgjedh Kuvendi. Në të dytin definohej roli dhe pozita kushtetuese e këtij institutcioni me rëndësi, që nuk dallonte në thelb nga definimet tjera të vendvee përreth: **AVMVe** mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve, kur ato u cenohen nga organet e administratës shtetërore dhe nga organet e organizatat e tjera që kanë autorizime publike (neni 77.2 i **KMVe**). AVMVe zgjedhet me kohëzgjatje prej tetë vjetësh me të drejtë edhe për një zgjedhje (neni 77.3 i **KMVe**). Kushtet për zgjedhje dhe shkarkim, për kompetencën dhe për mënyrën e punës së APMVe rregullohen me ligj (neni 77.4 i **KMVe**). Me amendamentet **XI** dhe **XII** në KMVe të datës 16 nëntor 2001 ka ardhur deri te ndryshimi i natyrës së këtij organi. Kuvendi zgjedh **APMVe** me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve, gjatë votimit duhet patjetër të ketë edhe shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve, të cilët u përkasin bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (pika e parë e amendamentit **XI**). APMVe i mbron të dre-

jtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve të cilëve ato u janë cenuar nga organet e administratës shtetërore dhe nga organet e organizatat që kanë autorizime publike. AVPMVe kujdes të veçantë i kushton mbrojtjes së parimeve të mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të bashkësive në organet e pushtetit shtetëror, organet e njësive të administratës lokale dhe në institucionet dhe shërbimet e tjera publike (paragrafi i dytë i amendamentit **XI**). Me amendamentin XII ka ardhur deri të shtimi i punëve të AVPMVe, të cilit tani i njihet e drejta për të emëruar një anëtarë të Komitetit për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, të cilin e themelon Kuvendi, nëse vetë ato bashkësi nuk janë në gjendje të bëjnë një gjë të tillë. Ky amendament nuk ka pasur të bëj me nenin kushtetues që definon rolin dhe pozitën e **AVPMVe**.

38.4. Agjencitë dhe institucionet e pavarura në Mal të Zi

Tri institucione të pavarura rregullohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë me KMZi, përkatësisht institucionet si vijon: **Avokati Popullit**, **Banka Qendrore** dhe **Institutcioni Shtetëror i Revizionit** (ISHRMZi). Ky i fundit, në fakt, është auditori i përgjithshëm i Malit të Zi, por që kushtetutëbërësi malazez ka përdorur një shprehje të vjetër që ka qenë në përdorim në ish-republikat jugosllave. Me këtë emërtim gjendet në Maqedoninë e Veriut, por si institucion ligjor, dhe në Serbi si një institucion kushtetues shtetëror.

Dispozitat kushtetuese për **Avokati Popullit** gjenden në pjesën e dytë të KMZi, kapitulli i gjashtë, që flet për liritë dhe të drejtat e njeriut. **Avokati Popullit** quhet **Mbrojtësi i lirivë dhe të drejtave të njeriut**, që në titull të kapitullit të gjashtë që i kushtohet këtij institucioni. Ai është një organ i pavarur dhe i mëvetësishëm që ndërmerr masa për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut (neni 81.1 i **KMZi**). AVPMZi ushtron funksionin e vet në bazë të KMZi, ligjit dhe marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, duke iu përmbajtur parimit të drejtësisë dhe drejtshmërisë (neni 81.2 i **KMZi**). Ai emërohet për gjashtë vite dhe mund të shkarkohet në rastet e përcaktuara nga ligji (neni 81.3 i **KMZi**).
Në pjesën e katërt të KMZi, që normon rregullimin ekonomik të vendit, bëhet fjalë për **Bankën Qendrore**. Fizionomia e saj është në harmoni me përcaktimet parimore të rregullimit ekonomik të Malit të Zi, të vëna në nenin 139, ku thuhet si vijon: "Rregullimi ekonomik bazohet në tregun e lirë dhe të hapur, ndërmarrësinë e lirë dhe konkurrencën, pavarësinë e subjekteve ekonomik dhe përgjegjësinë e tyre për detyrimet e marra në qarkullimin ekonomik, mbrojtjen dhe barazinë e të gjitha formave të pronësisë". **Banka Qendrore** definohet si organizatë e pavarur, përgjegjëse për stabilitetin monetar dhe financiar dhe funksionim të sistemit bankar (neni 143.1 i **KMZi**). Drejtohet nga Këshilli i **Bankës Qendrore** (neni 143.2 i **KMZi**). Guvernatori është menaxheri kryesor i **Bankës Qendrore** (neni 143.3 i **KMZi**).

ISHRMZi definohet si një organ suprem dhe i pavarur i revizionit shtetëror (neni 144.1 i **KMZi**). Ai kryen revizionin e ligjshmërisë dhe suksesit të drejtimit me pasurinë shtetërore dhe detyrat, buxhetet dhe të gjitha punët financiare të subjekteve, burimet e financimit të të cilave janë publike ose krijohet përmes përdorimit të pasurisë shtetërore (neni 144.2 i **KMZi**). **ISHRMZi** i paraqet Kuvendit raport vjetor (neni 144.3 i **KMZi**). Me këtë institucion drejton Senati (neni 144.4 i **KMZi**). Kryetari dhe anëtarët e Senatit të **ISHRMZi** gëzojnë imunitet funksional dhe nuk mund të thirren në përgjegjësi për mendimin e shprehur apo vendimin e dhënë në vijim të shqyrtimit të funksionit të vet, përveç kur bëhet fjalë për vepër penale (neni 144.5 i **KMZi**).

38.5. Agjencitë dhe institucionet e pavarura në Serbi

Zgjidhjet kushtetuese në **Serbi** janë më të qarta se në dy republikat ish-jugosllave sa i përket institucioneve dhe agjencive të pavarura, ani pse ato ngjasojnë shumë me zgjidhjet kushtetuese malazeze. Edhe kushtetutëbërësi serb, bankën qendrore, të cilën e quan bankë popullore (BQSerb) dhe auditorin e përgjithshëm, të cilin e quan njëjtë si kushtetutëbër**ësi** malazez, institucioni shtetëror i revizionit (ISHRSerb), i normon në kuadër të kapitullit të parë të pjesës së tretë të **KSerb** ("Rregullimi ekonomik dhe financat publike"). Që në fillim, në parimet themelore të rregullimit ekonomik dhe financave publike, neni 82.1 i **KSerb**, përcaktohet se "Rregullimi ekonomik në Republikën e Serbisë bazohet në ekonominë e tregut,

tregun e lirë e të hapur, lirinë e ndërmarrësisë, pavarësinë e subjekteve ekonomikë dhe barazinë mes pronësisë private dhe formave të tjera të pronësisë". **Serbia** definohet si një hapësirë unik ekonomike, me treg unik të mallrave, punës, kapitalit dhe shërbimeve (neni 82.2 i **KSerb**). Ndikimi i ekonomisë së tregut në pozitën sociale dhe ekonomike të të punësuarve nivelizohet përmes dialogut mes sindikatave dhe punëdhënësve (neni 82.3 i **KSerb**).

Banka popullore e Serbisë është bankë qendrore e Republikës së Serbisë, e pavarur dhe i nënshtrohet Kuvendit, të cilit i përgjigjet (neni 95.1 i **KSerb**). Me **BQSerb** udhëheq guvernatori, të cilin e zgjedh Kuvendi Serbisë (neni 95.2 i **KSerb**). Për **BQSerb** miratohet ligj i veçantë (neni 95.3 i **KSerb**).

ISHRSerb është organi më i lartë shtetëror i revizionit të mjeteve publike në Republikën e Serbisë, i pavarur dhe i nënshtrohet mbikëqyrjes së Kuvendit, të cilit i përgjigjet (neni 96.1 i **KSerb**). Edhe për këtë organ miratohet një ligj i posaçëm (neni 96.2 i **KSerb**).

Për dallim nga republikat tjera ish-jugosllave, Serbia në nenin 137 të **KSerb**, në fund të pjesës për ekzekutivin, por jashtë saj, ka vënë themelet kushtetuese për funksionimin e agjencive të pavarura. Këtë e ka bërë në paragrafët 2, 3, 4 dhe 5 të nenit 137. Disa autorizime publike mund të kalohen në ndërmarrje, institucione, organizata e individë, thotë paragrafi i dytë i këtij neni. Paragrafi i tretë, ndërkaq, është edhe më i qartë, sepse përcakton që autorizimet publike me ligj mund të kalohen për kryerje tek organet e posaçme përmes të cilave realizohet funksioni rregullator në disa fusha dhe veprimtari. Këto shërbime publike të kësaj natyre mund të formohen në të gjitha nivelet, përfshirë vetëqeverisjen lokale (neni 137.4 i **KSerb**). Veprimtaritë dhe punët për të cilat formohen shërbimet publike, rregullimi tyre dhe puna rregullohen me ligj.

Në fund, me një nen të vetëm, nenin 138, KSerb definon pozitën dhe rolin kushtetuese të **APSerb**. Ai është një organ shtetëror i pavarur, që mbron të drejtat e qytetarëve dhe kontrollon punën e organeve të administratës shtetërore, organeve kompetente për mbrojtjen e të drejtave pasurore dhe interesave të Republikës së Serbisë, si dhe punën e organeve e organizatave të tjera, ndërmarrjeve dhe institucioneve të cilave u janë besuar autorizime publike (neni 138.1 i **KSerb**). **APSerb** nuk është i autorizuar për të kontrolluar punën e Kuvendit të Serbisë, Presidentit të Republikës, Qeverisë, GJKSerb, gjyqtarëve dhe organit të akuzës (neni 137.2 i **KSerb**). APSerb e zgjedh dhe shkarkon Kuvendi, në pajtim me KSerb dhe ligjin (neni 137.3 i **KSerb**). Për punën e vet i përgjigjet Kuvendit (neni 137.4 i **KSerb**). APSerb gëzon imunitet si deputeti Kuvendit. Për imunitetin e saj/tij vendos Kuvendi (neni 137.5 i **KSerb**). Edhe për këtë organ miratohet një ligj i posaçëm (neni 137.6 i **KSerb**).

39. Komente dhe pyetje

39.1. Çka është pushtetit shtetëror?

39.2. Bashkësia shtetërore dallon nga bashkësitë tjera shoqërore pikërisht për shkak të **pushtetit**, i cili duhet të dallohet nga **forca.** Çka është kjo e fundit?

39.3. Çka është **sovraniteti** dhe cilat janë llojet e tij?

39.4. Sipas **M. Veber**, nënshtrimi i individëve ndaj urdhrave apo kërkesave të shtetit përbën një çështje ekzistenciale, që ndodhë në ndonjërën prej tri formave të manifestimit të pushtetit. Cilat janë ato forma?

39.5. Nga pushtetet tjera, **pushteti shtetëror** dallon për shkak se në tërë territorin shtetëror ai është pushteti më i lartë, pushteti suprem, që ka **tri karakteristika të dallueshme** që janë të pashmangshme për çdo pushtet, pa marrë parasysh sa është legjitim në kuptimin si më sipër. Cilat janë ato?

39.6. Pushteti shtetëror është një **institucion i tërësishëm** juridiko-kushtetues, njëjtë sikur shteti element i të cilit është, por ka **funksione** të ndryshme (kryen punë të ndryshme e të nduarndurshme). Diskutoni çfarë do të thotë kjo?

39.7. Përveç tri funksioneve klasike, ekzistojnë edhe disa veprimtari të tjera të shtetit, që nuk ushtrohen nga asnjëra prej gjymtyrëve kryesore të pushtetit shtetëror, e megjithatë përfaqësojnë autoritet publik, përkatësisht pushtet publik. Këto janë **autoritetet rregullative**. Diskutoni!

39.8. Çka janë **funksionet e dukshme socio-politike të shtetit** e çka **funksionet latente socio-politike të shtetit**?

39.9. Çka është **shteti minimal** e çka **shteti intervencionist?**

39.10. Organizimi i pushtetit, në rend të parë, është marrëdhënie juridike dhe politike mes të organeve të ndryshme të pushtetit shtetëror në nivel qendror (**organizimi horizontal**) dhe, së dyti, marrëdhënie juridike dhe politike në mes të organeve të pushtetit qendror dhe pushtetit në nivel më të ulët – pushtetit regjional, lokal dhe pushtetit në njësitë federale (**organizimi vertikal**). Kjo marrëdhënie është **marrëdhënie juridike**! Pse?

39.11. Në mesin e trupave të pushtetit shtetëror, përkatësisht organeve të pushtetit shtetëror ekzistojnë **organet që themelohen drejtpërdrejt me kushtetutë** dhe **organet që kanë rëndësi kushtetuese**. Në grupin e parë hyjnë krejt ato organe shtetërore që zënë pozitën e autonomisë së kualifikuar (**superiorem non recognoscens**) dhe që konsiderohen pushtet shtetëror në kuptimin e ngushtë dhe të plotë të fjalës, marrin pjesë në mënyra të ndryshme në realizimin dhe ushtrimin e funksionit politik të shtetit, përkatësisht marrin pjesë drejtpërdrejt në individualizimin e qëllimeve që shteti ia ka vënë vetes dhe synon t'i realizoj. Pse? Diskutoni!

39.12. Jo vetëm në Angli, por edhe gjetiu, para **Monteskies** dhe kohës moderne është menduar e diskutuar mbi ndarjen e pushtetit, të një lloji të atillë që të ndihmonte në organizimin sa më të mirë ose më të mirë të pushtetit shtetëror. Diskutoni!

39.13. Në çka konsiston dallimi mes **qeverisjes së përzier** dhe ndarjes së pushteteve?

39.14. Para instalimit të saj në **Angli** më 1653 me **Instrumentin i Qeverisjes**, megjithatë, **qeveria/kushtetuta e përzier** ka ardhur në shprehje në kolonitë angleze në Amerikën e Veriut, fillimisht në **Plymouth** e më pastaj edhe në kolonitë tjera. Diskutoni!

39.15. Të gjitha teoritë mbi ndarjen e pushtetit mund të ndahen sipas numrit degëve të pushtetit. Mbështetur në këtë kriter, ekzistojnë tri grupe të mëdha teorish. Diskutoni!

39.16. **Parimi i unitetit të pushtetit** nuk është shtjelluar aq shumë teorikisht, krahasuar me parimin e ndarjes së pushtetit, por as në praktikë nuk ka pasur një jetë të gjatë, gjë që ka bërë që të ngelet nën hijen e parimit të ndarjes së pushtetit. Çka nënkupton ky parim dhe çka e dallon prej parimit të ndarjes dhe baraspeshimit të pushteteve?

39.17. Cilat janë sistemet kryesore të pushtetit dhe mbi bazën e çfarë kritereve vendoset dallimi mes tyre?

39.18. **Impeachment**-i kalon nëpër dy dhomat e Kongresit. Diskutoni!

39.19. Sistemin parlamentar e karakterizon **pushteti ekzekutiv bicefal** (me dy koka). Pse?

39.20. **Sistemi i përzier i pushtetit** është model i parlamentarizmi që më së shpeshti lidhet me **KFr** të vitit 1958. Diskutoni!

39.21. Çka e karakterizon **sistemin e kuvendeve** dhe kur është shfaqur për herë të parë? Çka dallon ky sistem nga **sistemi presidencial**?

39.22. Pse origjina e parlamentit duhet të kërkohet në **Angli?**

39.23. Deri në **Luftën e Parë Botërore**, parlamenti është konsideruar institucion politik qendror, për të humbur këtë primat në favor të pushtetit ekzekutiv nga kjo kohë e tutje dhe në mënyrë graduale. Arsyet e depushtetizimit të parlamentit kanë qenë të shumta. Cilat janë ato?

39.24. Kujt i takon legjitimiteti në **sistemin zgjedhor proporcional** dhe çka dallon ky sistem nga të tjerët sa i përket **legjitimitetit**?

39.25. Cilët faktorë ndikojnë në numrin e përfaqësuesve në një parlament?

39.26. Për të fituar mandatin e përfaqësuesit kërkohet plotësimi i dy kushteve themelore: që kandidati të ketë të drejtën pasive zgjedhore dhe të fitoj numrin e caktuar të votave. Diskutoni!

39.27. Në rrethana të caktuara, mandati i përfaqësuesve mund të jetë më i shkurtër ose më i gjatë se ai i përcaktuar me kushtetutë e ligj. Pse?

39.28. Sipas natyrës, mandati përfaqësues mund të jetë **i detyrueshëm** (i lidhur) ose **jo i detyrueshëm**

(i lirë). Çka është njëri e çka tjetri?

39.29. Me qëllim të ruajtjes të natyrës së mandatit të lirë dhe ndarjes së pushtetit, përfaqësuesit gëzojnë imunitet. Diskutoni!

39.30. Çka është **imuniteti material?**

39.31. Çka është **imuniteti procedural?**

39.32. Dy imunitetet si më sipër, **imuniteti material** (lirimi nga përgjegjësia) dhe **imuniteti procedural** (imuniteti paprekshmërisë), nuk mbrojnë përfaqësuesit nga përgjegjësia disiplinore. Çka nënkupton kjo?

39.33. Me ndarjen e punëve shtetërore, që buron nga parimi ndarjes së pushtetit, parlamentit i ka takuar pushteti ligjvënës. Miratimi ligjeve përbën **kompetencën normative** të parlamentit. Përveç kompetencën normative, parlamenti ka edhe **kompetencën kontrolluese**, e cila kryesisht është e drejtuar kundër qeverisë (ekzekutivit). Një grup të posaçëm të punëve të parlamentit e formojnë **kompetencat në sferën zgjedhore dhe të personelit**. Krahas këtyre tri grupeve të kompetencave, parlamenti kryen edhe punë të tjera të ndryshme që mund të përmblidhen në një grup të ndarë. Diskutoni!

39.34. Funksioni **kushtetutëbër**ës i parlamentit nuk është veprimtari e tij primare. Pse?

39.35. **Funksioni normativ i parlamentit** nuk konsiston vetëm në ligjvënies dhe kushtetutëbërje, por edhe në nxjerrjen e akteve të tjera. Për cilat akte tjera bëhet fjalë këtu?

39.36. Cilat janë **instrumente**t e kontrollit parlamentar?

39.37. Çka është **interepelacioni?**

39.38. Çka është **votimi mosbesimit të qeverisë?**

39.39. Çka është instrumenti i **votimit konstruktiv të mosbesimit të qeverisë**, i cili ekziston në disa vende?

39.40. Një mjet krejtësisht specifik i kontrollit parlamentar është **votimi i besimit të qeverisë**. Në çka dallon nga **votimi mosbesimit të qeverisë**?

39.41. Me çka ka të bëj **kompetenca në sferën zgjedhore dhe të personelit?**

39.42. Cilat janë kompetencat tjera të parlamentit?

39.43. Çfarë dallon **seanca** nga **mbledhja** e parlamentit?

39.44. Parlamenti mban **mbledhje të rregullta** dhe **mbledhje të jashtëzakonshme**. Diskutoni!

39.45. Një mjet legal me të cilin shërbehet opozita gjatë debateve parlamentare është instituti i njohur si **obstruksioni** (ang.: **filibuster**). Për çka bëhet fjalë këtu?

39.46. Cilat janë **teknikat e votimit** në seancë?

39.47. Procedurën e ligjvënies si tërësi nuk e zbaton parlamenti, por ai ka rolin qendror sepse i takon faza fundamentale – shqyrtimi dhe vendosja. Diskutoni!

39.48. Propozimi i ligjit duhet të plotësoj **kushtet formale** dhe **kushtet përmbajtësore** (materiale). Çfarë do të thotë kjo?

39.49. Çka është e **drejta e vetos së thjeshtë** (suspenzive) e çka e **drejta e vetos absolute?**

39.50. Ligji hyn në fuqi me kalimin e një kohe të caktuar nga dita e publikimit. Si quhet kjo kohë ndryshe?

39.51. Përbërja e parlamentit jeton aq sa është mandati i plotë, që zakonisht është katër ose pesë vite. Ai mund të **shpërndahet**. Diskutoni dallimet e shpërndarjes së tij në sistemin parlamentar dhe në atë presidencial.

39.52. Kur është paraqitur për herë të parë e drejta për shpërndarje të parlamentit dhe kujt i ka takuar kjo e drejtë me kushtetutë?

39.53. Mbi shpërndarjen e parlamentit vendos qeveria, shefi i shtetit, por mund të shpërndahet edhe sipas fuqisë së kushtetutës (**ex constitutionem**). Cilat janë rastet kur parlamenti shpërndahet sipas fuqisë së kushtetutës?

39.54. **Ekzistojnë periudha kohore dhe situata kur parlamenti nuk mund të shpërndahet.** Cilat janë ato?

39.55. Me nxjerrjen e Kushtetutës së vitit 1974, Kosova për herë të parë fiton organin e vet ligjvënës, me autorizime origjinale ligjvënëse në sferat që kishin të bënin me **Krahinën Socialiste Au-**

tonome të Kosovës (KSAK), e cila, ani se ishte pjesë përbërëse e **Republikës së Serbisë**, gëzonte një autonomitet të plotë legjislativ në fushat e caktuara. Si ka qenë gjendja me kuvend në Kosovë para vitit 1974? Pas suprimimit të autonomisë së Kosovës nga diktatori serb Milosheviq, cili kuvend ka ekzistuar?

39.56. Çka ka qenë **Kuvendi i Kosovës** nën administratën e UNMIK-ut?

39.57. A ekziston aktualisht një ligj organik për Kuvendin e Kosovës? Si është gjendja me vendet përreth Kosovës?

39.58. Sa deputet i ka Kuvendi i Kosovës? Si zgjedhen ata?

39.59. Çka është pragu zgjedhor?

39.60. Çka është mandati i deputetëve në Kosovë dhe si nis ai?

39.61. Kur mbaron mandati i deputetëve para kohës e kur konsiderohet se Kuvendit i shkurtohet mandati?

39.62. Kush e konstaton ndërprerjen e mandatit të deputetit individual në Kuvendin e Kosovës?

39.63. Mandatin e deputetit e karakterizojnë dy cilësi: **papajtueshmëria** (neni 72 i KKos) dhe **imuniteti** (neni i 75 **KKos**). Diskutoni!

39.64. Çka ka thënë **GJKRKS** për imunitetin në rastin **KO 98/11** të datës 20 shtator 2011?

39.65. Përveç dispozitës së sipërcekur mbi papajtueshmërinë e përgjithshme, **KKos** në dispozitën e parë të nenit 73 flet edhe për **pamundësinë e kandidimit për deputet** të kategorive të caktuara të individëve, posteve dhe përgjegjësive. Diskutoni!

39.66. Sa i përket **natyrës juridike** të mandatit të deputetit, **KKos** e bën të qartë se mandati nuk është mandat i detyrueshëm (imperativ), por **mandat i lirë**. Çka do të thotë kjo? Si është gjendja në kushtetutat e vendeve fqinje lidhur me këtë?

39.67. Një tip i posaçëm i demokracisë është instaluar në Kosovë, **demokracia konsociacionale**, menjëherë pas mbarimit të luftës në qershor të vitit 1999, përmes rregullativës së administratës ndërkombëtare në Kosovë, përkatësisht rregullativës së **UNMIK-ut**. Pse?

39.68. Me **KKos** qartë përcaktohet modeli **konsociacional i demokracisë**. Ky model përshkon dhe reflektohet në **Deklaratën e Pavarësisë**, në preambulën e **KKos** dhe në çdo normë të saj. Diskutoni!

39.69. Në frymën e **demokracisë konsociacionale** në Kosovë ka qenë edhe një prononcim i **GJSKos** në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021, kur një grup kandidatësh që pretendonin se përfaqësojnë komunitetin boshnjak, me ndihmën e subjektit më të madh politik serb në Kosovë, arriti të deformoj vullnetin e komunitetit boshnjak. Diskutoni!

39.70. Krejt punët që kryen Kuvendi, që përbëjnë tërësinë e kompetencave të tij kushtetuese, mund t'i ndajmë në tri grupe: **normative; zgjedhore;** dhe **kontrolluese.** Diskutoni!

39.71. Procedura e prodhimit të ligjit kalon nëpër disa faza, brenda të cilave tri leximet e tij janë më të rëndësishmet. Diskutoni!

39.72. Projektligji **duhet të ketë një përmbajtje të caktuar**, që do të thotë se me **RrP** përcaktohen elementet thelbësore që duhet t'i përmbaj një tekst që mëton të shërbej si propozim i një ligji. Cilat janë ato kushte që përcaktojnë këtë përmbajtje thelbësore të një draftligji?

39.73. Ligjet shprehimisht të përmendura (numëruara) në nenin 81 të **KKos**, të njohura si **ligjet me interes vital**, miratohen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve plus me shumicën e njëjtë të votave të deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë në shumicë. Asnjëri nga **ligjet me interes vital**, nuk mund t'i nënshtrohet referendumit (neni 81.2 i KKos.). Cilat janë këto ligje?

39.74. Dispozitat kushtetuese mbi shpërndarjen e Kuvendit, në tërësinë e tyre mund të ndahen në dy grupe. Cilat janë ato? A ka të drejtë Qeveria të shpërndaj Kuvendin e Kosovës?

39.75. Cilat janë rastet kur Presidenti i Republikës **ex constitutionem** duhet të shpërndaj Kuvendin e Kosovës?

39.76. Cilat janë rastet kur Kuvendi Kosovës mund të shpërndahet nga Presidenti i Republikës së Kosovës?

39.77. Çfarë dallon Kuvendi i Kosovës nga Kuvendi i Shqipërisë?

39.78. Çfarë dallon Kuvendi i Maqedonisë së Veriut nga kuvendte e Malit të Zi dhe Serbisë?

39.79. Shikuar nga këndi historik i origjinës, shefi i shtetit mund të konsiderohet si **organi më i vjetër shtetëror**, krahasuar me organet tjera në kuadër të ndarjes horizontale të pushtetit. Diskutoni!

39.80. "Le roi n'administre pas, ne gouverne pas, il règne" ("Mbreti nuk administron, nuk qeverisë, ai mbretëron"). Çfarë do të thotë kjo thënie dhe kush e ka thënë?

39.81. Ardhja në pushtet e shefit të shtetit varet nga **forma e shtetit**. Çfarë do të thotë kjo?

39.82. Mënyra e ardhjes në pushtet përmes trashëgimisë së fronit, për rrjedhojë nënkupton edhe ekzistimin edhe të një statusi të posaçëm të personit të monarkut. Ajo/ai nuk është politikisht përgjegjës ("non-liability") dhe gëzon paprekshmëri ("non-violability"), përkatësisht posedon **imunitetin (lirimin) nga përgjegjësia** ("non-liability immunity") dhe **imunitetin e paprekeshmërisë** ("inviolability immunity"). Çfarë do të thotë kjo?

39.83. Kushtet për zgjedhjen për President të Republikës mund të ndahen në dy grupe: **të përgjithshme** dhe **të veçanta**. Cilat janë të parat e cilat të dytat?

39.84. Zgjedhja e presidentit të republikës drejtpërdrejt nga qytetarët, burimisht është krijuar në vendet me sistem presidencial, sipas modelit të SHBA. A ekziston kjo mënyrë e zgjedhjes së shefit të shtetit edhe në sistemet e përziera?

39.85. Procedurë e veçantë e zgjedhjes së drejtpërdrejt të presidentit ekziston në SHBA përmes zgjedhjes me **kolegj elektoral**. Çka është ky organ?

39.86. Zëvendësimi i Presidentit të Republikës mund të kufizohet në disa muaj, përkatësisht deri në zgjedhjen e Presidentit të ri të Republikës, kohë në të cilën ushtrimin e funksionit e kryen një zyrtarë tjetër i lartë shtetëror. Kush mund të jetë ai?

39.87. Fuqinë politike të Presidentit të Republikës e kufizon në veçanti e drejta e **kundërfirmës e qeverisë**. Çka nënkupton kjo?

39.88. Autorizimet e shefit të shtetit **mund të klasifikohen në dy grupe**: në grupin e parë mund të futen **prerogativat tradicionale** që nuk përfaqësojnë pushtetin apo fuqinë reale ekzekutive, kurse në të dytën hyjnë **prerogativat jo tradicionale**, ato që përfaqësojnë pushtetin real ekzekutiv. Diskutoni se çfarë hyn në grupin e parë e çfarë në të dytin?

39.89. Çfarë do të thotë maksima e njohur se mbreti kurrë nuk mund të gaboj ("The King Can Do No Wrong")?

39.90. Për dallim nga monarku, **përgjegjësia e Presidentit të Republikës** ekziston në dy anë – **politike** dhe **juridike**. Çka do të thotë kjo?

39.91. Mënyrë e posaçme e konstatimit të përgjegjësisë së shefit të shtetit është **impeachement**-i, që ekziston në të drejtën anglo-saksone dhe në shtetet me sistem presidencial të pushtetit. Diskutoni!

39.92. Presidenti i Republikës në Kosovë shpreh kategorinë **më shumë ceremoniale sesa ekzekutive** të shtetit, që është rrjedhje normale e dizajnit të tij kushtetutës. Dy janë funksionet bazike të shefit të shtetit kosovar: një, kryen detyrën më shumë ceremoniale të kreut të shtetit; dhe, dy, është i veshur me një numër të kompetencave kushtetuese, të cilat, në modelin aktual kushtetues, përcaktojnë vendimmarrje zinxhirore dhe definojnë pozitën e këtij organi kushtetues që është tipike për një sistem të pastër parlamentar. Diskutoni!

39.93. **Çfarë ka thënë Benjamin Konstan** për shefin e shtetit si **pushtet neutral dhe i ndërmjetëm**? Çfarë kanë thënë **Karl Shmit** dhe **Hans Kelsen** lidhur me të njëjtën çështje? Bëni krahasimin mes tyre.

39.94. A ka në Kosovë shefi i shtetit ndonjë **kompetencë ekzekutive autonome?**

39.95. Cili ka qenë thelbi i verdiktit të **GJKRKS** në rastin **Jahjaga**?

39.96. Në dimensionimin e Presidentit të Republikës si përfaqësues i unitetit të popullit, rol të rëndësishëm kanë luajtur aktgjykimi në rastin **Rrustemi et al v. Presidenti i Republikës** i datës 28 shtator 2010 dhe aktgjykimi i sipëcekur lidhur me rastin **Jahjaga**. Për çka bëhet fjalë këtu?

39.97. Cilat janë kompetencat e Presidentit të Republikës në Kosovë?

39.98. Neni 88 i **KKos** e rregullon çështjen e **papajtueshmërisë** së detyrës së presidentit me ndonjë detyrë tjetër. Çfarë ka thënë **GJKRKS** lidhur me këtë në rastin **Rrustemi et al v. Presidenti i**

Republikës?

39.99. Neni 89 i **KKos** rregullon çështjen e imunitetit të Presidentit të Republikës. Çfarë ka thënë GJKRKS lidhur me këtë në rastin e njohur të **imuniteteve të funksionarëve të lartë shtetërorë të Republikës së Kosovës**?

39.100. Çka dallon presidenti i Shqipërisë nga presidenti i Kosovës në aspektin e pozitës juridiko-kushtetuese?

39.101. Cili është dallimi mes shefit të shtetit në Maqedoninë e Veriut dhe në vendet tjera përreth Kosovës, gjithnjë duke pasur parasysh aspektin juridiko-kushtetues të dallimeve?

39.102. Çka është **pushteti ekzekutiv bicefal**?

39.103. Më qëllim të kuptimit sa më të mirë të vetë institucionit të qeverisë, e dobishme është të dallohen **llojet qeverisë**, të cilat klasifikohen sipas kritereve të ndryshme. Diskutoni këto kritere?

39.104. Kur fillon mandati i qeverisë?

39.105. Sipas ndarjes klasike të pushtetit, qeveria nxjerr akte nënligjore, më të rëndësishmet nga të cilat janë **rregulloret për zbatimin e ligjeve**. Në situatat e jashtëzakonshme, qeveria ngjitet më sipër me të drejtën për nxjerrjen e **dekreteve me fuqi ligjore** pa lejen paraprake të parlamentit, duke prodhuar ato në bazë të autorizimit të drejtpërdrejtë kushtetues. A duhet të miratohen këto nga parlamenti më pastaj? A ka në KKos kësi akte juridike? Cila është gjendja me dekretet me fuqi ligjore në vendet përreth Kosovës: a ekzistojnë ato në kushtetutat e këtyre e vendeve?

39.106. Nga dekretet me fuqi ligjore ka dallim legjislacioni i deleguar: këtu qeveria autorizohet nga parlamenti për nxjerrjen e **akteve me fuqi ligjore** gjatë **kohës së paqes**, përkatësisht gjatë jetës normale dhe të përditshme të shtetit. Çfarë do të thotë kjo? Ku ka lindur kjo praktikë? A ekziston kjo në Kosovë dhe vendet përreth?

39.107. Cilat janë instrumentet e kontrollit ndaj qeverisë që **drejtpërdrejtë** ose **tërthorazi** mund të çojnë në konstatimin e përgjegjësisë së saj?

39.108. Diskutoni rolin dhe pozitën kushtetuese të Qeverisë së Kosovës dhe krahasojeni atë me rolin dhe pozitën kushtetuese të Qeverisë së Shqipërisë?

39.109. Për të qenë në pajtim më **KKos**, autorizimi për të nxjerrë akte nënligjore duhet të plotësoj disa kushte. Cilat janë ato?

39.110. Ndarja vertikale **në mes të nivelit politik** dhe **nivelit civil të pushtetit ekzekutiv** përbën një karakteristikë të sistemeve kushtetuese demokratike që ofrojnë hapësirë për zhvillim të një strukture shtetërore që nuk ka prirje dhe afiliim partiak, dhe që përbën pjesën e përhershme, meritore, profesionale dhe civile të shtetit, që është **shërbimi civil**. Si është kjo në KKos dhe në kushtetutat e vendeve përreth Kosovës?

39.111. Neni 93.8 i **KKos** përcakton kompetencën e qeverisë për t'i propozuar Presidentit të Republikës emërimet dhe shkarkimet e të gjithë shefave të misioneve diplomatike të Kosovës. Diskutoni!

39.112. Diskutoni konceptin e a.q. kryeministrizim i qeverisë sipas neneve 93 dhe 94 të KKos dhe tregoni a vlen ky koncept për rastet e ministrave të komuniteteve joshumicë?

39.113. Neni 100 i KKos flet për **mosbesimin** dhe **votëbesimin.** Diskutoni këtë institut në planin krahasimor me zgjidhjet kushtetuese të vendeve përreth Kosovës!

39.114. Çdo gjë do humbej sikur organi ose zyrtari njëjtë, qoftë nga fisnikëria apo populli, të ushtronte pushtetin ligjvënës, pushtetin e ekzekutimit të ligjeve dhe pushtetin e gjykimit të krimeve ose zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mes personave privat. Kush i ka thënë këto fjalë?

39.115. Çka nënkupton parimi i **ligjshmërisë** dhe parimi i **pavarësisë** në punën e gjykatave dhe cilat janë trajtat e tyre në të cilat manifestohen?

39.116. Çka nënkuptohet me **parimin e detyrueshmërisë së vendimeve gjyqësore**, **parimin e unitetit të sistemit gjyqësor** dhe **parimin e përhershmërisë së gjykatave**?

39.117. Në parim, **Gjykata Supreme** ka rol **nomofilaktik**! Çka do të thotë kjo?

39.118. Për pavarësinë e gjyqtarëve të rëndësisë primare janë disa aspekte! Cilat janë ato?

39.119. Cilat janë parime procedurale, si garancione për pavarësinë e gjyqësorit?

39.120. Sistemi i drejtësisë në Kosovë ka një histori relativisht të gjatë. Në një fazë të zhvillimit të tij,

ai ka qenë pjesë integrale e sistemit të drejtësisë të Republikës së Serbisë (1945-1969), për të qenë një sistem autonom i drejtësisë pas ngjizjes së autonomisë së Kosovës në kuadër të ish-Jugosllavisë. Diskutoni!

39.121. Pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 1969 dhe Kushtetutën e KSAK-së të vitit 1974, me zgjerimin e funksioneve të Krahinës së Kosovës dhe pasurimin e autonomisë së saj, Kosova gati njëjtësohet me republikat jugosllave për nga funksioni i saj gjyqësor (me përjashtim të gjyqësisë që ka të bëj me realizimin e funksioneve unike për krejt territorin e Republikës së Serbisë, sepse Kosova atëbotë konsiderohej si pjesë përbërëse e Republikës së Serbisë). Diskutoni!

39.122. Sistemi i drejtësisë në Kosovë nën administratën e UNMIK-ut hyn në radhën e sistemeve të ”hibridizuara” apo ”internacionalizuara” të drejtësisë. Pse? Diskutoni!

39.123. Diskutoni sistemin e drejtësisë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008.

39.124. Me nxjerrjen e amendamentit kushtetues të datës 3 gusht 2015, përkatësisht me nxjerrjen e amendamentit nr. **24** në **KKos** (tani neni 162 i saj), u krijua baza e re kushtetuese për bartjen e tërësishme jashtë Kosovës të juridiksionit të saj gjyqësor, përfshirë juridiksionin në çështjet kushtetuese. Juridiksionet në fjalë, ai i gjyqësorit të rregullt dhe ai kushtetues, u bartën në të a.q. **Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar, në diskursin publik të njohura si Gjykata Speciale** me seli në Hagë. Diskutoni!

39.125. Diskutoni karakteristikat e sistemit të drejtësisë në Shqipëri!

39.126. Diskutoni karakteristikat e sistemit të drejtësisë në Maqedoninë e Veriut!

39.127. Diskutoni karakteristikat e sistemit të drejtësisë në Mal të Zi!

39.128. Diskutoni karakteristikat e sistemit të drejtësisë në Serbi!

39.129. Analizoni dallimet dhe cilësitë e përbashkëta mes sistemeve të drejtësisë në Kosovë dhe vendeve përreth saj.

39.130. Cilat janë funksionet dhe sistemet e gjyqësisë kushtetuese?

39.131. Çka është koncepti i **ligjvënësit negativ** sipas **Hans Kelsen**?

39.132. Cila është esenca e vendimit të GJSAm në rastin e njohur si **Marbury kundër Madison?**

39.133. Që një ligj të jetë në pajtim me kushtetutën, duhet të plotësohen **kushtet formale** dhe **materiale**. Çka nënkuptohet me kushte formale e çka me kushte materiale të kushtetutshmërisë?

39.134. Cilat kushte duhet të plotësohen për realizimin e **kontrollit konkret të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë**?

39.135. Si shkak për kontrollin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë shërben **kontesti kushtetues**, një mosmarrëveshje e palëve lidhur me një objekt dhe vlerë kushtetuese. Çka nënkuptohet me **kontest kushtetues** në kuptimin më të gjerë të fjalës dhe parë nga këndi i dogmatikës së pozitivizmit juridik të së drejtës kushtetuese?

39.136. Çka nënkuptohet me **kontroll represiv** të kushtetutshmërisë e çka me **kontroll preventiv**?

39.137. Çka nënkuptohet me **doktrinën mbi amendamentet jokushtetuese?**

39.138. Çka nënkuptohet me shprehjen **normavënës pozitiv** në gjyqësinë kushtetuese?

39.139. Cila është kompetenca themelore e organit të gjyqësisë kushtetuese?

39.140. Kosova ka një histori të gjyqësisë kushtetuese që shkoj përtej vitit 2008, kur u parashikua formimi i **GJKRKS**. Diskutoni gjyqësinë kushtetuese kosovare para vitit 2008!

39.141. Deri në qershor të vitit 2018, krahas **Bosnje-Hercegovinës** dhe **Lihtenshtajnit**, **Kosova** ka qenë vendi i tretë në **Evropë** që ka pasur në përbërjen e vet tre gjyqtarë ndërkombëtarë. Prania e gjyqtarëve ndërkombëtarë ka pasur natyrë të përkohshme. Diskutoni!

39.142. Çfarë përbërje ka sot **GJKRKS** dhe cilat janë kriteret për përzgjedhjen e gjyqtarëve kushtetuese dhe si bëhet caktimi i tyre?

39.143. Për të qenë gjyqtar kushtetues, diversiteti etnik, kulturor, gjuhësor dhe tjetër nuk përbën një kriter shprehimor e as ndonjë standard të përqafuar gjerësisht në **Evropë**. Në Kosovë ky nuk është rasti: në **KKos** ka gjetur një vend të veçantë respektimi i diversitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe tjetër. Diskutoni!

39.144. Diskutoni **papajtueshmërinë** në kontekstin e gjyqësisë kushtetuese në Kosovë! Çfarë do të thotë kjo kategori? A përfaqëson papajtueshmëria një aspekt thelbësor për ruajtjen e pavarësisë

objektive dhe integritetin e gjyqtarit kushtetues?

39.145. Diskutoni **privilegjet** në kontekstin e gjyqësisë kushtetuese në Kosovë! Çfarë do të thotë kjo kategori? A përfaqësojnë privilegjet një aspekt thelbësor për ruajtjen e pavarësisë objektive dhe integritetin e gjyqtarit kushtetues?

39.146. Diskutoni kategorinë e **imunitetit** në kontekstin e gjyqësisë kushtetuese në Kosovë! Çfarë do të thotë kjo kategori? A përfaqëson imuniteti një aspekt thelbësor për ruajtjen e pavarësisë objektive dhe integritetin e gjyqtarit kushtetues?

39.147. Pengesat që formojnë papajtueshmërinë, janë barriera **objektive** që përcaktohen në mënyrë të përgjithshme nga një normë dhe i shërbejnë pavarësisë së gjyqtarit dhe integritetit të tij, duke pasur për qëllim ruajtjen e natyrës së funksionit të gjyqtarit kushtetues. Këtë e ka konstatuar **GJKRKS** në njërin prej vendimeve të saj kur ka qortuar publikisht njërin prej gjyqtarëve të saj që kishte marrë pjesë aktive në një fushatë politike të organizuar nga njëra prej partive politike të Kosovës. Diskutoni se për çfarë rasti bëhet fjalë këtu!

39.148. Cili është dallimi mes **konfliktit të interesit** të një gjyqtari kushtetues dhe **papajtueshmërisë** në kuptimin **objektiv** (funksional)?

39.149. Rastet kur njëri prej gjyqtarëve të **GJKRKS** është duke ushtruar ndonjë post tjetër publik ose profesional për të cilën shpërblehet me pagesë pas marrjes së detyrës së gjyqtarit, duhet të merren vesh përmes vetëdeklarimit të saj/tij. Kë duhet ta informoj gjyqtari në një rast të tillë?

39.150. Ka shtete që nuk parashohin (ofrojnë) imunitet penal për gjyqtarët kushtetues, përkatësisht fare nuk kanë dispozita kushtetuese apo ligjore që rregullojnë imunitetet e gjyqtarëve kushtetues (apo gjyqtarëve të gjykatave të larta që kryejnë funksione kushtetuese). Në skajin tjetër, nuk janë të pakta shtetet që u njohin gjyqtarëve kushtetues kategorinë e **imunitetit të përgjithshëm/ absolut (non-violability)**. Si qëndron situata në Kosovë në këtë drejtim?

39.151. Lidhur me **shkarkimin** e gjyqtarëve të **GJKRKS**, në **KKos** gjendet vetëm një nen, neni 118. Çka përcakton ky nen?

39.152. Në **Kosovë** kontrolli i ligjshmërisë nuk bëhet nga ana e **GJKRKS**, por vetëm nga ana e gjyqësorit të rregullt. Çfarë nënkupton kjo? Diskutoni duke krahasuar me vendet përreth Kosovës që njohin kategorinë e kontrollit të ligjshmërisë si një kompetencë të gjykatës kushtetuese!

39.153. **KKos** nuk bën dallim në mes të interpretimit kushtetues (**constitutional interpretation**) dhe kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë (**judicial review**). Çka nënkupton kjo?

39.154. Kufizimi i juridiksionit të **GJKRKS** që ka ndodhur gjatë kohës së pavarësisë së mbikëqyrur ka pasur të bëjë me kufizimet si pasojë e ekzistimit të dispozitave specifike të natyrës së përkohshme në të drejtën kushtetuese pozitive të Kosovës së asaj kohe. Kjo periudhë ka zgjatur deri në vitin 2012, vit në të cilin janë shfuqizuar dispozitat e **KKos** që i jepnin epërsi absolute dispozitave të **Planit Ahtisari**. Këto lloje të kufizimeve kanë qenë imanencë e faktit të thjeshtë se **KKos** është derivat i drejtpërdrejtë i planit, jo anasjelltas. Diskutoni për çfarë kufizimesh bëhet fjalë këtu?

39.155. **GJKRKS** ka juridiksionin më të gjerë të mundshëm, krahasuar me gjykatat simotra në **Ballkan.** Ai është shumë i afërt me sistemin gjerman të gjyqësisë kushtetuese. Kjo do të thotë, me një fjalë, se ajo ka juridiksion mbi të gjitha veprimet e të gjitha autoriteteve publike në vend, përfshirë këtu gjyqësorin. Shumë pak çështje kanë ngelur jashtë juridiksionit të saj. Diskutoni juridiksionin aktual të **GJKRKS**!

39.156. Në vijim të ushtrimit të juridiksionit të saj si gardian e KKos, GJKRKS nxjerr dy lloje të vendimeve. Cilat janë ato?

39.157. Neni 116.1 i **KKos** normon efektin juridik të vendimeve. Ky nen përcakton si vijon: "[…] Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës". Kjo dispozitë e bën të qartë se forca juridikisht e detyrueshme e vendimeve të **GJKRKS** nuk përcaktohet ekskluzivisht vetëm nga cilësia e tyre përmbajtësore e brendshme dhe procedura në të cilën janë dhënë. Çka do të thotë kjo?

39.158. Çështja e **mendimeve mospajtuese** ka qenë një çështje mjaftë e diskutueshme gjatë draftimit të **Ligjit Nr. 03/L-121**. Autoritet ndërkombëtare të kohës fuqishëm kanë argumentuar se nuk

duhet lejuar mendimet mospajtuese për shkak se një zgjidhje e tillë do të shkaktonte më tutje fragmentimin e KKos përgjatë linjave etnike, fetare dhe dallimeve të tjera. Si për çudi, kanë qenë pikërisht gjyqtarët ndërkombëtarë ata që kanë insistuar në futjen e mendimeve mospajtuese në praktikën e **GJKRKS**. Diskutoni!

39.159. Vendimi për **masat e përkohshme** përbën një vendim të natyrës së përkohshme dhe urgjente me të cilin nuk zgjidhet çështja meritore, mirëpo as nuk prejudikohet zgjidhja e saj. Diskutoni!

39.160. Në rastin **Tomë Krasniqi vs. RTK dhe KEK** (2009), dy gjyqtarë të **GJKRKS** kanë bërë mendim mospajtues, në të cilin kanë kontestuar anën procedurale dhe materiale të kërkesës dhe vendimit lidhur me kërkesën. Njëri ndër këta gjyqtarë ka pasur konflikt të hapur të interesit, të cilin e ka heshtur dhe më vonë është kuptuar një gjë e tillë. Diskutoni se për çfarë bëhet fjalë këtu!

39.161. Cili është juridiksioni i **GJKSH-së**? Beni krahasimin e këtij juridiksioni me juridiksionin e **GJKRKS**.

39.162. Cili është juridiksioni i **GJKMVe?** Beni krahasimin e këtij juridiksioni me juridiksionin e **GJKRKS**.

39.163. Cili është juridiksioni i **GJKMZi?** Beni krahasimin e këtij juridiksioni me juridiksionin e **GJKRKS**.

39.164. Cili është juridiksioni i **GJKSerb**? Beni krahasimin e këtij juridiksioni me juridiksionin e **GJKRKS**.

39.165. Cili është funksioni themelor i **ushtrisë** në aspektin juridiko-kushtetues?

39.166. Sot ekzistojnë tri sisteme të plotësimit të radhëve të ushtrisë dhe organizimit të saj. Cilat janë ato? Diskutoni!

39.167. Cilat janë parimet themelore të organizimit të ushtrisë?

39.168. Ekzistojnë dy **forma kryesore të nënshtrimit të ushtrisë ndaj organeve dhe autoriteteve civile**. Cilat janë ato?

39.169. Ushtria tradicionalisht është materie kushtetuese, që rregullohet me norma kushtetuese. Si ligje themelore, kushtetuta që nga paraqitja e tyre në skenë në fund të shek. XVIII, kanë ngjizur traditën e futjes së disa qëndrimeve dhe dispozitave në lidhje me mbrojtjen, ose me interes për mbrojtjen, si dhe në lidhje me pozitën e forcave të armatosura. Dallimet mes kushtetutave në këtë drejtim kanë të bëjnë më shumë me numrin e dispozitave që i kushtohen materies së ushtrisë si dhe me përmbajtjen e zgjidhjeve të përqafuara kushtetuese. Janë përjashtim vendet kushtetutat e të cilave nuk përmbajnë dispozita për mbrojtjen dhe ushtrinë. Diskutoni!

39.170. Janë dy aspekte që më së shpeshti janë normuar me kushtetutë nga materia kushtetuese e ushtrisë. Cilat janë ato?

39.171. Cili është funksioni themelor i policisë?

39.172. Ushtria dhe policia në Kosovë, diskutoni!

39.173. Ushtria dhe policia në Shqipëri, diskutoni!

39.174. Ushtria dhe policia në Maqedoninë e Veriut, diskutoni!

39.175. Ushtria dhe policia në Mal të Zi, diskutoni!

39.176. Ushtria dhe policia në Serbi, diskutoni!

39.177. Çka nënkuptohet me **kuazi-amendamentim** kushtetues në kontekstin e rolit dhe pozitës kushtetuese të FSK-së?

39.178. Ngritja e shtetit administrativ, me fillim nga gjysma e dytë e shek. XIX, ka rezultuar në diferencimin institucional të pushtetit shtetëror. Kjo nënkupton që sot shumë detyra shtetërore kryhen (realizohen) nga ana e **agjencive dhe institucioneve** që veprojnë në një distancë të konsiderueshme nga institucionet kryesore të legjitimuara në mënyrë demokratike. Kalimi i përgjegjësive shtetërore në trupa të specializuara ka një histori të gjatë, por që gjysma e dytë e shek. XIX e ka vënë në pah këtë fenomen më shumë se çdo herë tjetër në të kaluarën. Diskutoni!

39.179. Në aspektin kushtetues, për aq sa përmenden dhe normohen me kushtetutë, çfarë janë agjencitë dhe institucionet e pavarura dhe çka dallojnë nga organet kushtetuese?

39.180. **Autoritetet e pavarura rregullative** operojnë në formë të **agjencive dhe institucioneve të**

pavarura, që janë të panumërta në sistemet kushtetuese të vendeve demokratike. Cilat janë funksionet që kryejnë ato?

39.181. Ani pse **autoritet e pavarura rregullative**, në përgjithësi, nuk ushtrojnë **pushtet shtetëror** në mënyrë të drejtpërdrejtë, veprimet e tyre mund të kenë ndikim të madh në vendimmarrjen politike. Pse?

39.182. Diskutoni vendin dhe pozitën kushtetuese të agjencive dhe institucioneve të pavarura në Kosovë!

39.183. Diskutoni vendin dhe pozitën kushtetuese të agjencive dhe institucioneve të pavarura në Shqipëri!

39.184. Diskutoni vendin dhe pozitën kushtetuese të agjencive dhe institucioneve të pavarura në Maqedoninë e Veriut!

39.185. Diskutoni vendin dhe pozitën kushtetuese të agjencive dhe institucioneve të pavarura në Mal të Zi!

39.186. Diskutoni vendin dhe pozitën kushtetuese të agjencive dhe institucioneve të pavarura në Serbi!

40. Lexim shtesë

- Didier Blanc, "Droit constitutionnel et droit international". *Revue française de Droit constitutionnel* Vol. 4 No. 64 (2005)
- Dominique Remy-Granger, "Le pouvoir de suffrage". Në Michel Troper et Dominiques et Chagnollaud (eds.), *Traité international de droit constitutionnel. Tome 2: Distribution des pouvoirs*
- Elliot Bulmer, *Dissolution of Parliament* (International IDEA: Stockholm, 2017)
- Elliot Bulmer, *Non-Executive Presidents in Parliamentary Democracies* (International IDEA: Stockholm, 2017)
- Elliot Bulmer, *Presidential Veto Powers* (International IDEA: Stockholm, 2017)
- Francis Deleperee, "L'Excecutif". Në Michel Troper et Dominiques et Chagnollaud (eds.), *Traité international de droit constitutionnel. Tome 2: Distribution des pouvoirs*
- Francis Hamon, "Le statut de partis politiques". Në Michel Troper et Dominiques et Chagnollaud (eds.), *Traité international de droit constitutionnel. Tome 2: Distribution des pouvoirs*
- François Saint-Bonnet, "Le parlement, juge constitutionnel (XVIe-XVIIIe **siecle)**" *Droits* Vol. 2 No 34 (2001)
- Herve Ascension, "Les relations exterieures". Në Michel Troper et Dominiques et Chagnollaud (eds.), *Traité international de droit constitutionnel. Tome 2: Distribution des pouvoirs*
- Jody C. Baumgartner and Mark H. Morris, "Presidential Power Unbound: A Comparative Look at Presidential Pardon Power". *Politics and Policy* Vol. 29 No. 2 (June 2001)
- Luke Devine, "Law & Leviathan: Redeeming the Administrative State by Cass R. Sunstein and Adrian Vermeule" *Osgoode Hall Law Journal* Vol. 59 No. 1 (Winter 2016)
- Marijana Pajvancic, *Parlamentarno pravo*. 2. Izdanje (Fondacija Konrad Adenauer: Beograd, 2008)
- William Seagle, "Rudolf von Jhering: Or Law as a Means to an End" *The University of Chicago Law Review* Vol. 13 No. 1 (December 1945)

PJESA E PESTË 5

ORGANIZIMI VERTIKAL I PUSHTETIT

1. Mbi ndarjen vertikale të pushtetit dhe format e rregullimit shtetëror

Përgjigjja në pyetjen së çfarë rregullimi shtetëror i duhet një vendi varet nga disa faktorë, të cilët nuk kanë natyrën e **faktorëve juridiko-kushtetues**. Ata janë: gjeografia e shtetit dhe kushtet klimatike, tradita dhe historia, niveli kulturor dhe ekonomik, përbërja nacionale, fetare, racore dhe numri i banorëve, karakteristikat psikologjike të banorëve dhe niveli arsimimit, ambienti politik e kështu me radhë. Kombinimi i këtyre faktorëve jep rezultate të ndryshme, që janë veçori e secilit shtet veç e veç. Për pasojë, edhe format e rregullimit shtetëror dallojnë nga një vend në tjetrin, në një masë të madhe ose të vogël. Për këta faktorë kanë shkruar filozofët e njohur të së drejtës, me fillim nga **Zhan Bodin** (Jean Bodin: 1530-1586), **Xhon Lloku** (John Locke: 1632-1704), **Tomas Hobes** (Thomas Hobbes: 1688-1679), **Monteskie** (Montesquieu: 1689-1755) dhe **Ruso** (Jean-Jacques Rousseau: 1712-1778). Kështu, ta zëmë, vendet e madhësive afërsisht të njëjta në popullsi dhe territor, siç janë Kina dhe India, megjithatë kanë forma të ndryshme të rregullimit shtetëror: shteti i parë është shtet unitar dhe shumë i centralizuar, kurse i dyti është shtet i përbërë, një federatë me një decentralizim të konsiderueshëm edhe brenda vetë njësive federale. Përkundër kësaj, si një lloj rregulli i pashkruar, mund të thuhet se, vendet me territor dhe popullsi të madhe, kryesisht janë me rregullim shtetëror federativ: Australia, Brazili, Gjermania, India, Meksiko, Nigeria, Rusia, SHBA.

Në çdo shoqëri ekziston ndarja në grupe të ndryshme: masa kundruall elitës, klasa e punëdhënësve kundruall punëtorëve, pakica që institucionalisht krijon dhe imponon vullnetin politik dhe shumica që këtë vullnet e pranon ose kundërshton, por edhe brenda vetë këtyre grupeve ekziston konflikti i interesave, antagonizmat dhe mosmarrëveshjet. Pikërisht forma e caktuar e rregullimit shtetëror mund të jetë rruga për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve shoqërore ose kthimin e tyre në masë të pranueshme që nuk rrezikon ekzistencën e shtetit dhe as nuk frenon zhvillimin e tij. Në këtë kuptim ka lindur, ta zëmë, teoria dhe praktika e **autonomisë politiko-territoriale** në dobi të ndonjë bashkësie etnike, fetare, gjuhësore ose tjetër, apo në dobi të ndonjë ishulli ose regjioni të largët nga qendra e pushtetit. E tillë ka qenë dikur autonomia që ka gëzuar **Kosova** sipas **kushtetutës së Jugosllavisë** së vitit 1974 (Kushtetuta e RSFJ-së 1974), mbi bazën e së cilës ka nxjerrë edhe kushtetutën e vet të po atij viti (Kushtetuta e KSAK-së). Por autonomia shpesh paraqitet si një zgjidhje kalimtare dhe e përkohshme. Një tjetër formë e rregullimit shtetëror është treguar si zgjidhje e përhershme, e qëndrueshme dhe e pranueshme për tejkalim dhe përballim të mosmarrëveshjeve shoqërore që lindin nga shkaktarët me bazë etnike, fetare, racore, kulturore dhe historike- **federata**.

Ndarja vertikale e pushtetit shpreh apo shpërfaq rregullimin e brendshëm shtetëror, të cilin e karakterizon një masë e caktuar e decentralizimit, përkatësisht marrja e vendimeve politike dhe ushtrimi i pushtetit jashtë qendrës shtetërore, në njësitë e brendshme politiko-territoriale. Për dallim nga **ndarja horizontale e pushtetit**, që ka të bëj me marrëdhëniet mes organeve të pushtetit, mes disa titullarëve të pushtetit shtetëror, në rend të parë mes pushtetit ekzekutiv dhe pushtetit ligjvënës (dhe kushtetutëbërës), ndarja vertikale prek problemin e organizimit të shtetit, format e shtetit. Mbi një territor shtetëror mund të ekzistojnë disa mënyra të organizimit të marrëdhënieve mes radhëve të ndryshme territoriale, mes pushtetit qendror dhe kolektiviteteve infra-shtetërore, mes qendrës dhe periferisë. Pushteti i vendimmarrjes, pushteti normativ, me fjalë të tjera, mund të jetë i ndarë sipas **modelit unitar** dhe sipas **mod-**

elit pluralist. Nga karakteri unik (shteti unitar) ose i përbërë (shteti federal) i qendrës së vendosjes varet modeli (forma) i shtetit. Në **modelin unitar** ekziston një qendër e vetme e vendosjes politike, një qendër e vetme e pushtetit, e veshur me pushtet ekskluziv normativ për prodhimin e rregullave që zbatohen në krejt territorin shtetëror (në rend të parë kushtetuta dhe ligjet shtetërore). Shteti unitar është një organizatë politiko-juridike homogjene, në të cilën mbretëron parimi homogjenitetit. **Franca** është një shembull i kompletuar i këtij modeli, edhe për faktin se ka shërbyer si shembull i shtetit unitar gjetiu nëpër botë.[1] Sipas **modelit pluralist**, ekzistojnë më shumë qendra të pushtetit, ashtu që shteti qendror e ndan pushtetin normativ me autoritetet tjera që janë më poshtë, që nënkupton ndarjen e ushtrimit të pushtetit shtetëror dhe autoritetit publik me njësitë federale, regjionet, bashkësitë autonome etj.[2] Organet shtetërore quhen **organe qendrore** sepse zakonisht e kanë selinë në qendrën shtetërore, në kryeqytet, kurse organet në krejt nivelet tjera të pushtetit hyjnë në grupin e **organeve joqendrore**. Nëse do të paramendonim një shtet krejtësisht të centralizuar, atëherë në të nuk do të ekzistonte ndarja vertikale e pushtetit ngaqë krejt funksionet e pushtetit do të kryheshin prej një vendi, përkatësisht nga niveli qendror. Për këtë arsye ndarja vertikale e pushtetit është ngushtësisht e lidhur, në fakt e pandashme nga **decentralizimi.** Vetë natyra e ndarjes vertikale e pushtetit varet nga **shkalla e decentralizimit**. Me fjalë të tjera, ndarja e përparuar vertikale e pushtetit nënkupton më shumë kompetenca dhe numër më të madh të organeve joqendrore.

Ndarja e pushtetit mes organeve të nivelit të ndryshëm përfshinë degë, kompetenca e të cilave shtrihet në krejt territorin shtetëror. Këto quhen **organe shtetërore**. Organet tjera kompetenca e të cilave nuk shtrihet në krejt territorin shtetëror quhen organe të **njësive federale**, **organe të autonomisë** ose **organe të regjionit**. Në nivelin e tretë dhe më të ulët të pushtetit gjenden **organet e vetëqeverisjes lokale**. Krahas këtyre tri niveleve, shteti mund të ketë edhe nivele të tjera të pushtetit: në mes të vetëqeverisjes lokale dhe autonomisë territoriale mund të ekzistojnë nivelet e pushtetit në nivel të **rretheve** dhe në **metropole**. Ndarja vertikale e pushtetit në **federata** nënkupton nivelin e pushtetit të njësisë federale që gjendet menjëherë pas pushtetit qendror (shtetëror). Krahas kësaj, federatat mund të kenë organizimin e tyre vertikal të pushtetit në rang të regjioneve, provincave, qarqeve, qyteteve etj., që mund të diferencojnë (dallojnë) njësitë federale të shtetit të njëjtë.

Nga thuajse dyqind shtetet anëtare të OKB-së (193 sosh dhe dy anëtarë vëzhgues–Vatikani dhe Palestina), shumica e theksuar e tyre janë **shtete unitare**, në ndërkohë që, afërsisht, rreth njëzet janë vende me formë federale të rregullimit shtetëror. Disa vende mund të futen në formën e posaçme të shteteve regjionale, shembull tipik i të cilave janë **Italia** dhe **Spanja**. Forma e **shtetit regjional** nuk është në tërësi e përfunduar në aspektin teorik dhe as në atë praktik, por qëndron si model mes **shtetit federal** dhe **shtetit unitar të decentralizuar**. Regjionet ose krahinat në **shtetin regjional** nuk janë të mëvetësishme, siç janë njësitë federale në një federatë, por përfaqësojnë **forma të bashkësive territoriale që gëzojnë autonomi të konsiderueshme politike**, më të lartë se niveli i zakonshëm. Në të gjitha format e sipërcekura të shteteve, sidoqoftë, ekziston **një rrjet i dendur i njësive territoriale** të niveleve të ndryshme të pushtetit, kompetencave dhe shkallës së ndryshme të mëvetësisë. Kjo përbën një domosdoshmëri në shtetin bashkëkohor, i cili ushtrimin e pushtetit duhet t'ia përshtat hapësirave të caktuara brenda shtetit, specifikave të tyre dhe popullsisë që jeton në to. Në të njëjtën kohë, shtetet demokratike ndërtojnë një rregullim të atillë të brendshëm shtetëror, ku sigurohet që qytetarët në çdo nivel të pushtetit të kenë mundësi të zgjedhjes se përfaqësuesve të vet dhe në një masë të caktuar të ushtrojnë pushtet në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Dy janë **format themelore të rregullimit shtetëror**, të ndërtuara mbi bazën e ndarjes vertikale të pushtetit, të cilat dallohen për nga karakteristikat e tyre të dallueshme reciprokisht – **shteti unitar** (ose

[1] Hélène Simonian-Gineste**,** *Droit constitutionnel en schémas*. 8e **édition** (Ellipses: Paris, 2021), fq. 32.

[2] Louis Favoreu, Patrick Gaïa, Richard Ghevontian, Jean-Louis Mestre, Otto Pfersmann, André Roux, Guy Scoffoni, *Droit constitutionnel*. 21e edition (DALLOZ: Paris, 2019), fq. 467 - 468.

i thjeshtë) dhe **shteti federal** (ose i përbërë). Në shtetin e thjeshtë nuk ekziston ndarja e kompetencave shtetërore, nuk ekzistojnë forma shtetërore të llojit të njësive federale si në federatë. Shteti unitar nuk ka konkurrentin e vet në pushtetin shtetëror brenda shtetit: pushteti kushtetutëbërës dhe ligjvënës është një, siç është edhe vullneti politik që krijon kushtetutën dhe ligjet. Në shtetin federal, ndërkaq, gjendja paraqitet ndryshe, sepse ekzistojnë më shumë pushtetet kushtetutëbërëse dhe ligjvënëse dhe vullnete politike që i prodhojnë pushtetet e tilla. Shteti unitar në origjinën e vet është definuar si **një dhe i pandashëm**, qysh në **Kushtetutën e Francës** të vitit 1791 (KFr). Ky definim kësisoj i shtetit unitar nuk ka qenë dhe nuk përbën pengesë që shteti tillë të jetë në të njëjtën kohë edhe ”shtet laik, demokratik dhe social”, siç definohet në paragrafin e parë të nenit një të **KFr** të vitit 1958, aktualisht në fuqi.[3] Më këtë definim, theksi vihet te homogjentiteti i pushtetit, përkatësisht te udhëheqja e politikës shtetërore nga një vend (qendër). Një homogjenitet dhe pandashmëri e tillë e pushtetit nuk haset (gjendet) në **shtetin e përbërë**. Në shtetin unitar, ligjet janë të detyrueshme për të gjithë në tërë territorin shtetëror, në ndërkohë që në federatë merren parasysh specifikat e njësisë federale. Forma përmes së cilës shteti unitar i afrohet shtetit federal është trajta e **shtetit unitar të decentralizuar**, në të cilin ekzistojnë njësitë politiko-territoriale, siç janë regjionet, krahinat, rrethet që kanë **kompetencat e tyre burimore**. Në rastet kur këto njësi ushtrojnë pushtetin ligjvënës, ekzekutiv dhe, më rrallë, edhe atë gjyqësor, atëherë vetëm me **një analizë të hollësishme** mund të konstatohet nëse bëhet fjalë për federatë apo për shtet unitar me decentralizim të lartë të theksuar. Analiza duhet të përfshij dhe të fokusohet njëkohësisht në analizimin e vëllimit të kompetencave të njësive federale dhe të njësive të decentralizuara të shtetit unitar, në hulumtimin e rregullimit dhe ndarjes së kompetencave, studimin e sistemit të kontrollit të organeve joqendrore, vëllimit të pushtetit ligjvënës, mënyrës së zgjidhjes së konfliktit për kompetencë mes organeve qendrore dhe atyre joqendrore, si dhe shumë dimensione të tjera të marrëdhënieve juridiko-kushtetuese brenda shtetit si tërësi. Si formë e posaçme e shtetit unitar mund të konsiderohet edhe **unioni i bashkuar**, që është një formë e rregullimit shtetëror në të cilin ekzistojnë më shumë ligjvënës, jo vetëm një. Si shembull i kësaj është **Britania e Madhe** në të kaluarën, përkatësisht deri në decentralizimin e konsiderueshëm që ndodhi me procesin e bartjes së kompetencave, i njohur si **devolution**, që nisi në decenien e fundit të shekullit XX. Britania e Madhe ka përfaqësuar formën specifike të shtetit unitar, unionin e bashkuar që ka lindur me bashkimin historik të pjesëve të saj (**Anglisë** dhe **Velsit** në vitin 1536, **Anglisë** dhe **Skocisë** në vitin 1707, **Britanisë së Madhe** dhe **Irlandës** në vitin 1800). Me fitimin e qeverisë dhe parlamentit vetjak në vitin 1998, Skocia dhe Velsi shndërrohen në territore me autonomi politike, ngjashëm me **Irlandën e Veriut** që kishte ekzistuar më herët. Britania e Madhe akoma hyn në grupin e shteteve unitare me një decentralizim të zhvilluar, por që me **procesin e devolucionit** më shumë shkon kah **rregullimi shtetëror federal**. Nuk përjashtohet mundësia e shpërbërjes së shtetit me shkëputjen e **Skocisë**: pas referendumit të dështuar mbi shkëputjen në vitin 2014 është paralajmëruar një referendum i ri, i cili akoma nuk dihet se kur do të mbahet. Ka pasur paralajmërim se ai do të mbahet pas përfundimit me sukses të **BREXIT**-it, por që nuk ka ndodhur deri në shkrimin e këtyre rreshtave (prill 2023). Mungesa e një kushtetute të shkruar, megjithatë, bën që devolucioni në këtë vend të konkretizohet me një delegim të kompetencave të pushtetit, por që kurrë nuk privon parlamentin nacional nga e drejta për të ndërhyrë, përfshirë edhe me qëllim të revokimit të kompetencave të deleguara, dhe pa të drejtën e organit joqendror për ankimim të këtij vendimi në ndonjë organ që mbikëqyr kushtetutshmërinë.[4]

Shteti unitar është forma dominante dhe më e vjetër e rregullimit shtetëror. Përgjatë shekujve ka qenë formë e vetme e rregullimit shtetëror, deri në fund të shek. XVIII kur formohet konfederata e parë dhe, më pas, edhe federata e **SHBA**-ve. Në të kaluarën kanë ekzistuar forma të ndryshme të aleancave dhe lidhje mes shteteve dhe bashkësive të ndryshme politike, nga polisi antik, qytetet mesjetare në **Holandë**,

[3] Louis Favoreu, Patrick Gaïa, Richard Ghevontian, Jean-Louis Mestre, Otto Pfersmann, André Roux, Guy Scoffoni, *Droit constitutionnel*, fq. 635-657.

[4] Luciano Vandeli, “Formes d’Etats: Etat regional, Etat decentralize“. Në Michel Troper et Dominiques et Chagnollaud (eds.), *Traité international de droit constitutionnel. Tome 2: Distribution des pouvoirs* (Dalloz: Paris, 2012) fq. 54-76, në fq. 73-74. Më shumë për të gjitha format e shtetit, cf. edhe në Louis Favoreu, Patrick Gaïa, Richard Ghevontian, Jean-Louis Mestre, Otto Pfersmann, André Roux, Guy Scoffoni, *Droit constitutionnel*, fq. 467-562.

Gjermani dhe **Itali**, **lidhja Hanseatike** (Hanseatic League: 1356-1862), "konfederata" e **Perandorisë së Shenjtë Gjermane** (Holy Roman Empire: 962-1806) e deri te lidhjet ekzistuese politike, ushtarake dhe ekonomike me shteteve, të cilat, megjithatë, nuk janë shtete të reja por aleanca mes shteteve. Disa aleanca të tilla, me kohë janë shndërruar në shtete federale.

Lidhja e shteteve ka formën e **unionit të shteteve** (**konfederatës**). Anëtarët e unionit ose konfederatës janë shtete që janë bashkuar në një lidhje **të lirë politike**, me qëllim të mbrojtjes së ndonjë interesi dhe kryerjes së punëve të përbashkëta. Anëtarët lidhjen mund ta braktisin në çdo kohë, me vullnetin e tyre. E kundër me **lidhjen e shteteve** është **lidhja shtetërore** (**federata**). Kjo formë e shtetit formohet me bashkimin e bashkësive politike, të cilat vetë pushojnë së qeni shtete. Shteti federal është **formë shumë më e fuqishme e lidhjes politike**, krahasuar me lidhjen e shteteve (unionin/konfederatën), pa të drejtën e daljes së shteteve anëtare-njësive federale. Federatat janë **shumëanëtarshe**, federatat me dy anëtarë janë të rralla dhe dukuri kalimtare. Këto të fundit, **federatat dyanëtarshe**, nuk kanë pasur jetë të gjatë, janë ndarë pas një kohe të shkurtër, kurse shtetet anëtare janë bërë shtete të pavarura dhe sovrane e federata është prishur. Rasti i tillë ka qenë **Pakistani** (1955-1971), i përbërë nga dy njësi federale: **Pakistani Perëndimor** dhe **Pakistani Lindor**. Ky i fundit ka shpallur pavarësinë dhe është bërë shtet sovran dhe i pavarur, me emrin tjetër që edhe sot e kësaj dite e mban – **Bangladesh**. I pari, ndërkaq, pas mbarimit të operacioneve luftarake është bërë ai që është sot Pakistani. **Çekosllovakia** ka qenë federatë (1968-1992), nga e cila me rrugë paqësore kanë dalë Çekia dhe Sllovakia. **Republika Federale e Jugosllavisë** (RFJ) e përbërë nga Serbia dhe Mali i Zi, ka pasur jetë të shkurtër (1992-2003), siç ka pasur edhe Bashkësia Shtetërore Serbi-Mali i Zi (BSHSMZi: 2003-2006), që u krijua nga transformimi i **RFJ-së** në këtë bashkësi shtetërore. Nga **BSHSMZi**, përkatësisht nga **RFJ** u krijuan shtetet e sotme - **Serbia** dhe **Mali i Zi**. Ky i fundit u bë shtet më 2006, kur u shkëput nga Bashkësia Shtetërore. Më këtë, **ipso iure**, edhe Serbia u bë shtet sovran dhe i pavarur. Për dallim nga federatat dyanëtarshe, **federatat shumëanëtarshe** janë më të qëndrueshme dhe më jetëgjatë. Federata më e gjatë në botë, **SHBA**, ka 50 njësi federale; federata me më së shumti banorë, **India**, ka 29 anëtarë; më e madhja federatë në botë, **Rusia**, ka 85 njësi federale me statuse të ndryshme juridiko-kushtetuese.

Shteti regjional, formë e veçantë e rregullimit shtetëror, nuk është në tërësi i ndarë nga karakteristikat që posedojnë dy format si më sipër – shteti unitar dhe shteti i përbërë. Kjo formë mund të definohet edhe si **shteti unitar me shkallën më të lartë të decentralizimit**. Në literaturë është konceptuar si **lloj i ndërmjetëm i shtetit**, mes shtetit unitar dhe shtetit federal.[5] Formimit të **shtetit regjional**, si një zgjidhje kushtetuese, i kanë parapri krijimi i rrethanave specifike historike dhe politike në dy vendet ku ai u krijua, në **Itali** (1948) dhe **Spanjë** (1978). Kjo formë është kategori e veçantë e rregullimit shtetëror për aq sa dallon nga decentralizimi substancial në një shtet unitar dhe federalizimi, si dy forma të dallueshme në çdo rast. Arsyet për regjionalizim të shtetit janë të ngjashme me ato që lidhen me formimin e federatave, por kushtet politike janë të tilla që nuk prodhojnë pëlqim për federalizim të shtetit. Arsyet, pra, janë të natyrës **historike**, **etnike** (**nacionale**), **gjuhësore**, **gjeografike**, **ekonomike**, **kulturore**. Për shkak të kësaj ngjashmërie shkakore me federatën, **shteti regjional** mund t'i përbashkoj anët e mira të federatës dhe të shtetit unitar dhe të mënjanoj dobësitë e njërës dhe formës tjetër. Në këtë mënyrë, shteti regjional mund ta largoj rrezikun nga shpërbërja e federatës për shkak të separatizmit të ndonjë njësie federale, nga shkaku se regjioni nuk është element konstituiv, përbërës i shtetit, siç është njësia federale, por e kundërta e tij – ai (regjioni) ka lindur me vetë kushtetutën e shtetit. Në të njëjtën kohë, në shtetin regjional mund të barten më shumë kompetenca në nivelin regjional, sesa është rasti me decentralizimin standard në një shtet unitar, aq sa shteti të ngelet unitar kurse vetë regjioni të mbetet i kënaqur me nivelin e mëvetësisë. Me shkallë të ndryshme të decentralizimit brenda shtetit, gjithashtu mund të arrihet respektimi i specifikave dhe synimeve politike të regjioneve të caktuara (atyre që kërkojnë më shumë autonomi dhe atyre që këtë nuk e kërkojnë). E

[5] Luciano Vandeli, "Formes d'Etats: Etat regional, Etat decentralize", fq. 57.

thënë me fjalë të tjera, kjo formë e shtetit, **shteti regjional**, mundëson përgjigje ndaj kërkesave të forta për autonomi që rrjedhin nga grupet territoriale lidhur me veçoritë e theksuara të tyre. Pa braktisur vërtetë formën unitare, formula regjionaliste ofron mundësi për tejkalim të kufijve të decentralizimit (auto-administrimit) dhe për veshje të regjioneve me një **autonomi të vërtetë politike**, si përgjigje ndaj kërkesave të grupeve territoriale.[6] Kështu, ta zëmë, neni 2 i **Kushtetutës së Italisë** të vitit 1948 (KIt), aktualisht në fuqi, afirmon në mënyrë simultane unitetin dhe regjionalizmin: "Republika është një dhe e pandashme, njeh dhe promovon autonomitë lokale". Ngjashëm edhe **Kushtetuta e Spanjës** e vitit 1978 (KSp), në nenin 2, thotë për sa vijon: "Kushtetuta bazohet në unitetit e pandashëm të kombit spanjoll, vendin unik dhe të pandashëm të krejt spanjollëve, që njeh dhe garanton të drejtën për autonomi të nacionaliteteve dhe regjioneve nga të cilat përbëhet, dhe solidaritetit mes tyre".

Brenda secilës prej formave të mësipërme të rregullimit shtetëror ekziston niveli më i ulët i pushtetit, niveli lokal dhe më i afërt me qytetarin, me organizim të ndryshëm nga shteti në shtet (**njëshkallësh** - kur ekziston vetëm një nivel i organeve lokale, **dyshkallësh** – kur ekzistojnë dy organe, **treshkallësh** – me tri organe, dhe kështu me radhë). Nëse njësia lokale gëzon një pavarësi politike, atëherë ajo quhet **vetëqeverisje lokale**. Nivelet lokale të pushtetit janë të organizuara në sistem organesh të vetëqeverisjes lokale, i cili normohet me akte juridike shtetërore dhe lokale. Bashkësitë lokale nuk duhet domosdo të jenë krijesa juridike të organeve qendrore të shtetit, ani pse ky më së shpeshti është rasti. Në këtë kontekst, i veçantë dhe më i njohuri është **sistemi tradicional anglez i vetëqeverisjes lokale**, bazën e të cilit e përbëjnë famullitë (**parishes)**, mbi të cilat qëndrojnë qarqet (**districts**) dhe në fund kontetë (**counties**). Ky sistem ka lindur krahas dhe pavarësisht pushtetit qendror. Organe kryesore të pushtetit lokal janë këshillat dhe kryetari, përkatësisht kryebashkiaku. Kjo bazë e organeve me kohë është përplotësuar me disa kategori, përmes së cilave ka ardhur deri të ndërtimi i një sistemi të komplikuar të pushtetit lokal: **niveli i përbashkët**, ku hyjnë njësitë e veçanta organizative (**unitary authorities**), qyteti i Londrës (**London city**) dhe ishujt Silli (**Silly Isles**); niveli i sipërm i vetëqeverisjes lokale, ku hyjnë rrethi jometropolitan dhe rrethi metropolitan dhe Londra e Madhe; dhe, së fundi, niveli i poshtëm i vetëqeverisjes lokale, ky hyjnë qarqet jometropolitane (**non-metropolitan districts**), qarqet metropolitane (**metropolitan boroughs**) dhe qarqet e Londrës (**London boroughs**).

2. Shteti unitar

Shteti unitar ose i thjeshtë është formë e rregullimit shtetëror që përfshinë shtetet me vëllim e nivele të ndryshme të decentralizimit dhe centralizimit të pushtetit shtetëror. Mënyra e marrjes së vendimeve në nivel qendror shtetëror, krahasuar me federatën, është më e thjeshtë. Kjo sepse, nivelet më të ulëta të pushtetit, kryesisht nuk marrin pjesë në marrjen e vendimeve shtetërore. Kjo formë e rregullimit shtetëror, shteti unitar, ka lindur si rezultat i nevojave zhvillimore, në një moment të caktuar historik, me qëllim të tejkalimit të **dromcimit permanent të shtetit feudal** dhe formimit të shtetit më efektiv në qeverisje. Ky shtet u quajt **shteti absolut**, e formës së **monarkisë absolute**, një shtet që është unitar, i pandashëm dhe që nuk lejon që për punën shtetërore dhe të interesit të përgjithshëm të vendoset në shumë qendra, siç kishte qenë rasti me shtetin feudal. Qëllim i shtetit unitar, që nga kjo kohë, ngelet i njëjtë: që me kushtetutë e ligje të ndërtohet pushteti që mund të merr vendim me kohë dhe në mënyrë të vlefshme për krejt territorin e shtetit. Për këtë arsye, ky shtet shpesh cilësohet edhe **shteti territorial**, ose **shteti vestfalian**, për shkak se pikë ndarëse në këtë zhvillim, përkatësisht në shkatërrimin e shtetit feudal, merret **Paqja e Vestfalsisë** (1648). Monolitetit dhe qëndrueshmëria e shtetit unitar mund të duroj kritika për shkak të mungesës së demokracisë në vendimmarrje, rrethanë që mund të tejkalohet me procesin e decentralizimit të rregullimit të brendshëm. Ajo që është e saktë, në aspektin historik, ka të bëj me faktin që shteti territorial eliminoi të gjithë konkurrentët e pushtetit që kishin ekzistuar në shtetin e fragmentuar feudal, me fillim nga fshati, dioqeza, rrethi, kështjella, qyteti, parohia dhe format tjera të lojaliteteve feudale të banorëve.

[6] Hélène Simonian-Gineste, *Droit constitutionnel en schémas*, fq. 60.

U mor vesh, ka dallime substanciale me shtetin absolut unitar të kohës, i cili u krijua pas **Paqes së Vestfalisë**, si dhe të atij modeli të shtetit unitar që u krijua në fund të shek. XVIII, që merret si pikë nisëse në ndërtimin e shtetit unitar siç e njohim sot. Kjo fillon me Francën dhe revolucionin e vitit 1789, ku shteti unitar bazohet në premisën e ndarjes së pushtetit shtetëror. Cilësitë themelore të shtetit unitar, tani e tutje fillojnë të ndërtohen në mënyrë graduale dhe me një natyrë tjetër, që përfshinë demokratizimin e këtij shteti, ku forma më e shprehur e tij ngelet koncepti i decentralizimit (në të gjitha format e manifestimit që shtjellohen më poshtë). Në këto cilësi hyjnë, në rend të parë, fakti se, organet qendrore të shteti unitar, përkatësisht organi kushtetutëbërës, ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, që përfaqësojnë shtetin si tërësi. Funksioni normativ, por edhe ai ligjvënës, mund të ushtrohet pjesërisht nga ana e organeve joqendrore, ta zëmë, nga parlamenti regjional. Në mënyrë të ngjashme, edhe funksioni ekzekutiv dhe administrativ mund të ekzistojnë në nivel të mesëm dhe lokal të pushtetit në shtetin unitar, në ndërkohë që pushteti gjyqësor, sipas rregullit, është unik dhe lihet në duart gjyqësorit të shtetit. Në shtetin unitar, pushteti qendror, me **kushtetutë e ligje**, krijon njësitë tjera territoriale, duke përcaktuar kompetencat e tyre në tërësi ose në pjesë të caktuara. Kjo nënkupton se burimi i kompetencave dhe autorizimeve pushtetore të njësive territoriale në shtetin unitar është kushtetuta dhe ligjet nacionale, jo vullneti politik i njësive të tilla. Më së shpeshti, shteti unitar normon pozitën kushtetuese të organeve regjionale dhe lokale të pushtetit në nivel parimi dhe të përgjithshëm, duke u nisur nga rregulli se këto organe nuk marrin pjesë në formimin dhe punën e organeve shtetërore. Në këtë drejtim ekzistojnë përjashtime, në rastet kur në dhomën e dytë të parlamentit hyjnë përfaqësuesit e regjioneve dhe të vetëqeverisjes lokale (Spanja, Sllovenia), duke ndërtuar kësisoj pushtetin ligjvënës në nivel nacional. Sa i përket pushtetit ekzekutiv, përfaqësuesit e njësive territoriale nuk marrin pjesë në formimin dhe punën e qeverisë qendrore dhe kjo përbën një rregull thuajse pa përjashtim.

2.1. Karakteristikat, punët dhe llojet e shtetit unitar

Si një karakteristikë themelore e **shtetit unitar** mund të merret **prezumimi i vlefshmërisë** së akteve juridike dhe politike të organeve qendrore në tërë territorin shtetëror dhe fuqia e tyre e përgjithshme detyruese (i detyrojnë të gjithë). Kjo nënkupton që ligji i miratuar në parlament, zbatohet në tërë territorin shtetëror, vlen për krejt shtetasit apo për krejt qytetarët, përveç nëse, përjashtimisht, me vetë ligj nuk ngushtohet fusha e vlefshmërisë së tij. E njëjta vlen edhe për aktet e përgjithshme të pushtetit ekzekutiv. Cilësi tjetër e shtetit unitar është **homogjeniteti i organeve** të pushtetit qendror, të cilat nuk janë vendi ku puqen përfaqësuesit e njëjtë ose të barabartë të pjesëve të ndryshme të shtetit, por prapa të cilëve qëndron tërësia e sovranitetit popullor. Në përbërjen e tyre mund të jenë ministra, deputetë, gjyqtarë nga hapësirat e fushat e ndryshme të shtetit, por nuk janë përfaqësues të atyre hapësirave ose fushave por funksionarë dhe zyrtarë shtetërorë të organeve të pushtetit, përfaqësues të krejt shtetit. Në shtetin unitar çdo herë ekzistojnë **organet joqendrore**, të cilat ve-primtarinë e tyre e kryejnë në një hapësirë ose fushë më të ngushtë (me përjashtim të shteteve të vogla, "mikro shteteve", si p.sh., Andora në Pirineje, Monako, Vatikani, të cilat nuk kanë nevojë për të tilla organe). **Organet joqendrore** mund të ekzistojnë vetëm në njërin nivel të pushtetit, zakonisht në nivelin e pushtetit lokal, por mund të formohen edhe në nivele të ndryshme të pushtetit lokal dhe të ndërmjetëm. Niveli i ndërmjetëm i pushtetit mund të jetë pjesë e pushtetit lokal, pjesë e pushtetit qendror (organet e zhvendosura apo të dislokuara qendrore) si dhe bashkësi territoriale me shkallë të caktuar të autonomisë. **Organet joqendrore** të pushtetit lokal nuk janë konkurrencë e organeve të pushtetit qendror, për shkak se nuk kanë kompetenca të njëjta dhe nuk ushtrojnë pushtetin shtetëror, as nuk janë pjesë e njësisë politike e cila, si në rastin e njësisë federale, ka formën gjysmë-shtetërore.

Shteti unitar ka një kushtetutë, pushtetin ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor e ushtrojnë organet qendrore. Kjo nënkupton se ekziston vetëm një parlament, zakonisht njëdhomësh, me pushtet kushtetutëbërës dhe ligjvënës, pastaj një qeveri nën të cilën gjendet administrata shtetërore, një gjyqësor unik me një gjykatë supreme kompetent për krejt territorin shtetëror. Këtyre organeve individuale

nga secila degë e pushtetit duhet shtuar edhe gjykatën kushtetuese, që ka kompetencë në krejt territorin shtetëror. **Prezumimi i kompetencës**, lidhur me atë se kush ka të drejtë t'i rregulloj fushat përkatëse të marrëdhënieve shoqërore, çdo herë ekziston në favor të shtetit. Edhe në rastet e caktuara kur ekziston konflikti për kompetencë lidhur me atë se kush është kompetent për të kryer një punë konkrete, organi qendror ose organi joqendror, kompetent do të jetë organi shtetëror. Kjo nënkupton se çdo gjë që nuk është lënë, në mënyrë shprehimore me kushtetutë e ligj, në kompetencë të niveleve më të ulëta të pushtetit, ngelet në kompetencë të shtetit.

Ndarja e punëve publike dhe kompetencave në shtetin unitar paraqet një domosdoshmëri, për shkak se është e pamundur që të gjitha punët të kryhen nga një vend, nga një qendër shtetërore. Marrëdhënia mes organeve qendrore dhe organeve joqendrore të pushtetit reflektohet në vëllimin dhe cilësinë e punëve që do të kryejnë organet joqendrore, kurse vetë kjo marrëdhënie varet nga ajo nëse politika zyrtare shkon kah dobësimi i centralizmit në shoqëri dhe demokratizimi i saj, me qëllim afrimin e pushtetit sa më afër popullit, ose e kundërta e kësaj. Në këtë kuptim, është e qartë se **organet joqendrore** nuk mund të kryejnë punë që bien në domenin ekskluziv të punëve shtetërore, siç janë: marrëdhëniet ndërkombëtare, mbrojtja e vendit, sistemi monetar. Organet joqendrore kryejnë punë që kanë të bëjnë me interesa të ngushta, zhvillimin e regjionit ose të njësisë së vetëqeverisjes lokale.

Kriteri themelor sipas të cilit dallohen **punët burimore** dhe **punët e besuara** (bartura, deleguara) të **organeve joqendrore** ka të bëjë me **natyrën materiale** dhe **natyrën formale** të punëve në fjalë, pastaj me **regjimin juridik të kontrollit**. Punët e organeve joqendrore ato që përmbajtësisht duhet të kryhen në nivelin regjional ose lokal, sepse janë të rëndësisë së tillë, sikur janë, ta zëmë, mirëmbajtja e rrugëve regjionale, punët komunale në qytet, shpallja e referendumit lokal për vetëkontribut dhe kështu me radhë. Në kuptimin formal, ndërkaq, punët burimore të organeve joqendrore janë ato që u janë garantuar me kushtetutë dhe që kryhen në mënyrë të pavarur në bazë të kushtetutës dhe aktit të tyre nënligjor, pa përcaktimin: "në pajtim me ligjin". Kjo sepse, kur ekziston ky përcaktim, atëherë në praktikë mund të vij (dhe zakonisht vjen) deri te ngushtimi apo deformimi i autorizimeve burimore të organeve joqendrore, gjë kjo e natyrshme ngaqë ligjin e nxjerr parlamenti qendror kurse aktin nënligjor vetë autoriteteve regjionale ose lokale në vijim të zbërthimit të autorizimeve të tyre të garantuara me kushtetutë. **Objekt kontrolli** i punëve burimore të organeve joqendrore është **ligjshmëria** e kryerjes së tyre. Kontrolli ka të bëj me atë nëse punët në fjalë kryhen në pajtim me ligj ose kundër ligjit (dhe akteve të tjera juridike). Nëse organi joqendror ka sjell një akt në kundërshtim me ligjin, ta zëmë, lidhur me ndërtimin e një objekti, pushteti qendror aktin e tillë mund ta abrogoj ose anuloj (**e drejta e anulimit**). Organet qendrore këtu nuk kanë të drejtë të abrogojnë dhe anulojnë aktet e organeve joqendrore që nuk janë në kundërshtim me ligjin as të japin udhëzime të detyrueshme mbi mënyrën e sjelljes së tyre gjatë kryerjes së punës që është në kompetencë të tyre burimore. **Punët e besuara** pushteti qendror zakonisht i bartë me ligj (i delegon) të organet joqendrore. Këto janë punë burimore shtetërore, të cilat, me qëllim të realizimit të tyre me efikas ose për shkaqe politike, shteti i ka bartur në kompetencë të nivelit joqendror të pushtetit. Këto janë, ta zëmë, punët policore të sigurisë dhe mbrojtjes së njerëzve dhe të pasurisë, të cilat iu besohen policisë regjionale ose lokale (ta zëmë në **Britaninë e Madhe**, përmes **devolucionit**). Me kompetenca, shteti bartë edhe një pjesë të mjeteve me të cilat mbulon shpenzimet e kryerjes së tyre. Te punët e bartura (deleguara) për kryerje në organet joqendrore, **kontrolli është i plotë** dhe përfshinë, përveç **ligjshmërisë**, edhe **kontrollin e oportunitetit**, përkatësisht kontrollin nëse ka qenë me vend puna e kryer. Kjo nënkupton që, nëse organi qendror gjen se, puna e besuar nuk është kryer siç duhet, jo mjaftueshëm mirë, në mënyrë efikase dhe me vend, atëherë mund të abrogoj ose anuloj pasojat e saj juridike dhe kompetencën e bartur më herët ta rimarrë ose punën e besuar ta kaloj për kryerje në një organ tjetër joqendror. Këtu organi qendror mund të jep udhëzime të detyrueshme për punën e organit joqendror. Bartja e punëve mund të bëhet edhe **nga niveli regjional në atë lokal**: regjioni mund të kaloj kryerjen e punëve të veta burimore në nivelin më të ulët të pushtetit brenda territorit të vet, ta zëmë brenda qytetit.

Në ndarjen e punëve në shtetin unitar mund të dominojë **parimi i decentralizimit** ose **parimi i dekoncentrimit**. Në shtetin e rregulluar në bazë të parimit të decentralizimit, organet joqendrore kanë punët e tyre burimore, të cilat janë të vëllimit dhe kualitetit më të mirë nëse decentralizimi është i zhvilluar. Krahas këtyre punëve, organet joqendrore mund të kryejnë edhe punë të cilat ua beson pushteti qendror. Nëse në shtet dominon parimi i dekoncentrimit, atëherë shteti është i rregulluar në mënyrë të centralizuar. Këtu organet joqendrore nuk kanë punë burimore, por janë kompetent vetëm për kryerjen e atyre punëve që ua beson pushteti qendror.

2.1.1. Shteti unitar i decentralizuar

Rregullimi i brendshëm i shtetit unitar më së shpeshti është ndërtuar mbi parimin e **decentralizimit.** Kjo nënkupton më shumë liri, pushtet dhe demokraci për njësitë politiko-territoriale në llogari të dobësimit të centralizimit në shoqëri. Shteti i decentralizuar unitar nënkupton që organet joqendrore kanë kompetenca burimore, të vëllimeve dhe cilësive të ndryshme, që tregon nivelin e arritur të decentralizimit. Më shumë decentralizim nënkupton më shumë kompetenca në dobi të njësisë politiko-territoriale joqendrore dhe më shumë qeverisje demokratike për krejt territorin e shtetit, sepse pushteti i vërtetë është më afër popullit. Përveç filozofëve klasikë të modernitetit që i cituan më sipër, edhe **Aristoteli** (Aristotle: 384-322 p.e.s.) ka folur për problemin e madhësisë së bashkësive politike, nga këndi i demokratizimit të tyre, dhe ka vënë në dukje se, në bashkësitë e vogla, ku njerëzit njihen mes vete dhe janë ngushtësisht të lidhur me interesa të përbashkëta, përfaqësojnë të kundërtën e pushtetit qendror anonim, të depersonalizuar dhe të largët.[7] Këtu shfaqet, megjithatë, problemi përhershëm i fuqisë ekonomike dhe mjeteve financiare, sepse bashkësitë e vogla shpesh nuk mund të sigurojnë mjete për nevojat dhe zhvillimin e tyre.

Shteti unitar me një decentralizim të zhvilluar të brendshëm në kuadër të njësive të mëdha politiko –territoriale, më së afërmi është me **federatën**. Realizimi i një decentralizimi të zhvilluar mjegullon ndarjen tradicionale të shteteve sipas kriterit të rregullimit të brendshëm në shtete unitare dhe shtete federale. Në këtë kuptim, çdo ditë e më shumë bëhet i vështirë dallimi i shtetit të decentralizuar si kolektivitet, që është i ndarë në njësi e kolektivitete që nuk gëzojnë statusin e shteteve, nga **federata** në të cilën pjesët e brendshme përfaqësojnë format shtetërore, por pa pavarësi e sovranitet, i cili ngelet në duart e federatës. Krahas kësaj, pjesët e brendshme të njësisë federale mund të kenë decentralizim aq të zhvilluar sa, përveç vetëqeverisjes lokale, kanë edhe regjionet si nivel i ndërmjetëm i pushtetit. Decentralizimi është proces, i cili, nëse zhvillohet në vazhdimësi, në shtet sjell deri te ndryshimet në rregullim të brendshëm ashtu që, shteti unitar, çdo ditë e më shumë, në thelb, fillon të duket i mbindërtuar me elemente të shtetit të përbërë (ta zëmë, Britania e Madhe dhe Spanja).

Ndryshimet në pushtetin ligjvënës janë ilustrimi më i mirë i **shtetit të decentralizuar**. Ligjvënies si një kompetencë burimore shtetërore i ngushtohet hapësira me krijimin e mundësisë kushtetuese për ligjvënie të **pushtetit joqendror të ndërmjetëm**. Me ligje regjionale, në pajtim me kushtetutën dhe bazat juridike që mund të përcaktohen me ligjin shtetëror, rregullohet ndonjë fushë apo veprimtari shoqërore për territorin e regjionit (ta zëmë, arsimi, mbrojtja sociale, shëndetësia etj). Në **dy pushtetet tjera**, zakonisht nuk prodhohen kësi pasoja nga decentralizimi i shtetit. **Pushteti ekzekutiv** përcakton dhe realizon politikën shtetërore në tërë territorin e bashkësisë politike, që nënkupton mundësi vendosjeje vetëm në nivel shtetëror. Organet në nivelet e ulëta që janë të ngjashme me ekzekutivin qendror – qeveritë regjionale ose këshillat lokalë, nuk mund të përcaktojnë asnjë pjesë të politikës shtetërore, sepse nuk janë organe të pushtetit ekzekutiv, por bartës apo realizues të funksionit ekzekutiv në regjion, qark, komunë, qytet etj. Të ngjashëm me shefin e shtetit janë kryetarët e regjioneve, kryebashkiakët dhe

[7] Miller, Fred D, *Nature, Justice, and Rights in Aristotle's Politics* (Oxford University Press: Oxford, 1997), kapitulli "Introduction: The Argument of Aristotle's Politics" (duke iu referuar librit monumental "Politika" të Aristotelit).

kryetarët e komunave, të cilët gjithashtu nuk janë organe të pushtetit ekzekutiv të decentralizuar, por ushtrojnë funksionin ekzekutiv, përfaqësojnë njësinë politiko-territoriale dhe udhëheqin me të. Përveç kësaj, **decentralizimi** përfshinë vendimmarrjen në çështjet administrative, të cilat në një pjesë janë kompetencë e organeve të administratës lokale ose regjionale. Këto organe gëzojnë pavarësi në punën e tyre, por i nënshtrohen **mbikëqyrjes së ligjshmërisë** nga ana e organeve të administratës shtetërore ose qeverisë. Afërsisht e njëjta gjë vlen edhe për **pushtetin gjyqësor**: ekziston një rregull që **pushteti gjyqësor** nuk ndryshon organizimin e vet në procesin e decentralizimit, që nënkupton se gjykatat ngelin pjesë e pushtetit shtetëror qendror, ato janë organe shtetërore, pa marrë parasysh se çfarë është kompetenca e tyre lëndore dhe territoriale. Dega e pushtetit gjyqësor ndërtohet mbi parime që saktësisht e reflektojnë këtë, siç janë: parimi i unitetit të pushtetit gjyqësor, parimi i sigurisë juridike, parimi i barazisë para ligjit etj., të cilat mund të realizohen me lehtësi vetëm nëse gjyqësori është një degë unike e pushtetit shtetëror në krejt territorin e shtetit. Organizimi i pushtetit gjyqësor bazohet në **hierarkinë e brendshme**, ku të gjitha gjykatat në shtet janë pjesë e pandashme e pushtetit të njëjtë dhe unik – pushtetit gjyqësor.

Në shtetin e decentralizuar unitar, organet shtetërore qendrore **kontrollojnë ligjshmërinë** e punëve burimore që kryejnë organet joqendrore të pushtetit. Me këtë, organet joqendrore nuk privohen nga të drejtat, por kanë autorizime kushtetuese e ligjore për të mbrojtur kompetencat, punët dhe aktet e tyre, nga veprimet e kundërligjshme të organeve të pushtetit qendror. Ato mund t'iu drejtohen gjykatave ose gjykatës kushtetuese, të cilët vlerësojnë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e aktit të përgjithshëm me të cilin është anuluar, abroguar ose ndaluar akti i organit joqendror, përkatësisht mund të kërkojnë anulimin ose abrogimin e aktit individual të nivelit më të lartë të pushtetit me të cilin cenohet domeni burimor i punës së organit joqendror.

Kryerja e punëve **jashtë qendrës** mund të organizohet sipas sistemit të **vijës njëkahëshe** dhe **vijës dykahëshe**. E para nënkupton ekzistimin e organeve joqendrore që kryejnë punët burimore dhe punët e deleguara nga shteti. Të tilla janë, ta zëmë, organet e komunës me kompetenca burimore dhe kompetenca të deleguara, pranë të cilave nuk ekzistojnë organe të dislokuara shtetërore. Në sistemin e vijës dykahëshe ekzistojnë dy lloje të organeve: njëri lloj janë organet qendrore të fushuara, të cilët kryejnë punë e organeve qendrore jashtë selisë së tyre, kurse lloji tjetër janë organet joqendrore që kryejnë punët burimore dhe ato që iu janë besuar nga pushteti qendror. Kështu, ta zëmë, në hapësirën e rrethit apo qarkut ekzistojnë organet e dislokuara të pushtetit qendror, krahas organeve lokale që kryejnë, përveç punëve burimore, edhe punët që u janë besuar nga shteti.

2.1.2. Shteti unitar i centralizuar

Shumë më i rrallë është rregullimi i brendshëm i shteteve bazuar në parimin e **dekoncentrimit**. Këto janë shtete unitare me centralizim të tërësishëm ose të pjesshëm të kompetencave shtetërore në një vend, në ndërkohë që kryerja e vetëm një pjese të vogël të punëve **dislokohet** (dekoncentrohet/zhvendoset) prej selisë së pushtetit shtetëror. Arsye për dislokim (zhvendosje) është nevoja për kryerje efikase të punëve. Në formën e **centralizimit të tërësishëm** të shtetit unitar, vetëm organet ekzistuese konsiderohen organe shtetërore dhe vetëm atyre iu takon tërë pushteti shtetëror. Një gjë e tillë praktikisht është e pamundur, përveç në shtete fare të vogla, në mikro-shtete. Në shtetin me **centralizim të pjesshëm**, një pjesë e punëve shtetërore burimore bartet tek organet joshtetërore për kryerje. Këto organe nuk kanë kompetencë burimore, gjë që nënkupton se shkalla e lirisë dhe pavarësisë në vendimmarrje është e papërfillshme dhe, për rrjedhojë, edhe përafrimi i pushtetit qytetarëve në njësitë më të ulëta territoriale është krejtësisht minimal.

Centralizimi ose **unitarizimi** është një proces i kundërt me procesin e decentralizimit. Centralizimi është rrugë e zvogëlimit të kompetencave të pushtetit joqendror dhe organeve të tij, si në vëllim ashtu edhe në cilësi, dhe kalimi i tyre në pushtetin qendror. Kjo është pasojë e vendimit politik të shtetit,

për të cilin zakonisht nuk kërkohet pëlqim nga njësia territoriale joqendrore. Unitarizimi i shtetit ka për qëllim final unitarizmin, në të cilin, nisur nga parimi i pushtetit sovran në shtet, shteti rregullohet ashtu që me të të udhëhiqet nga një vend. Ne shtetet e centralizuara unitare, organet joqendrore nuk janë të pavarura në kryerjen e punëve të besuara (deleguara), por duhet të ndjekin udhëzimet dhe instruksionet që i marrin nga organet qendrore. Mbikëqyrja mund të bëhet gjatë tërë kohës së kryerjes së punës së deleguar, kurse kontrolli mund të ushtrohet edhe pas kryerjes së punës së besuar. Organet vendore joqendrore këtu nuk kanë instrumente juridike për t'u mbrojtur nga autoritetet e pushtetit qendror.

Shtetet unitare të centralizuara janë kryesisht kategori historike, të tejkaluara në të shumtën e rasteve. Si e tillë mund të përmendet e a.q. **Republika Bataviane** (1795-1806), e cila gjatë kohës së **Napoleonit** (Nopelon Bonaparte: 1769-1821) ka trashëguar **Holandën** dhe ka qenë e rregulluar sipas modelit të **Francës** së asaj kohe.[8] Një shembull tjetër i tillë në hapësirat e **Ballkanit** ka qenë ish-**Jugosllavia** mbretërore, nga vitit 1929 e deri në **decentralizimin asimetrik** që ndodhi me formimin e **Banovinës Kroate** (1939).[9] Nga vendet me sistem demokratik, aktualisht **Franca** (Republika e Pestë e themeluar më 1958) mund të klasifikohet si republikë unitare, me një centralizim jo të plotë, në të cilën forma e tillë e rregullimit shtetëror është formë tradicionale që nga Republika e Parë (1792). Ndër vendet jodemokratike të botës së sotme, si shembull tipik mund të përmendet **Kina** komuniste.

3. Shteti i përbërë

3.1. Unioni

Nën këtë emërtim mund të futen format e nduarndruarshme të organizimit, nga bashkimet sportive që bashkohen në unione sportive (FIFA, UEFA), deri te subjektet ekonomike që bashkohen në unione ekonomike (oda) dhe bashkësitë e ndryshme fetare. Këtu, megjithatë, nuk bëhet fjalë për unionin si bashkësi politike. Shtetet bashkohen dhe formojnë bashkësinë specifike politike, unionin, i cili përfshinë forma të ndryshme të lidhjeve ndërkombëtare të shteteve që krijohen falë rrethanave të caktuara politike. Këto rrethana e bëjnë të veçantë çdo union. Unionet kanë pasur anëtarë, qëndrueshmëri dhe organizim të ndryshëm, kurse deri të krijimi i tyre ka ardhur me vullnetin e shteteve ose përmes aneksimit. Pushojnë së ekzistuari me vdekjen e sundimtarit të përbashkët të anëtarëve të unionit ose me pushimin e interesave të shteteve anëtarëve për të qëndruar në union. Me ndërprerjen e unionit, shtetet anëtare bëhet të pavarura ose unioni zëvendësohet me ndonjë formë tjetër të rregullimit shtetëror.

Si shembull i unionit që është krijuar me vullnet të shteteve anëtare dhe me kohë është shndërruar në një lidhje të fortë shtetërore është **Britania e Madhe**. Fillimisht është krijuar unioni i Anglisë dhe Uelsit në vitin 1535, më pas unioni Anglisë me Skocinë në vitin 1707, që ka sjell deri te themelimi i **Britanisë së Madhe**. Një shembull tjetër i unionit jetëgjatë paraqet edhe **Unioni Poloni-Lituani**

[8] **Republika Bataviane** (frëngjisht: **République Bataviane; holandisht: Bataafse Republiek**) është krijuar pas pushtimit të Holandës në fushatën e franceze të viteve 1794–1795. Është formalizuar me kushtetutën e vitit 1798, ka pasur një qeveri të centralizuar, sipas modelit të **Direktoratit Francez** dhe ka qenë e lidhur me Francën me një aleancë. Në mars të vitit 1805, **Napoleoni** ka ndryshuar sistemin e qeverisjes edhe njëherë: Republika Bataviane u riemërua si **Komonvelti Batavian** kurse pushteti ekzekutiv iu dha një lloji diktatori, që ishte zyrtari më i rëndësishëm në vend. Në qershor të vitit 1806, Komonvelti u zëvendësua nga **Mbretëria e Holandës** nën kurorën e vëllait të vogël të Napoleonit, **Luigjit** (*Louis* Napoléon *Bonaparte: 1778-1846*). Kjo monarki zgjati deri në korrik të vitit 1810, kur provincat holandeze të veriut u futën në **Perandorinë e parë franceze** (1804-1814).

[9] Banovina Kroate është themeluar me **Dekretin e Regjencës** të datës 26 gusht 1939, që mban titullin "Dekreti mbi Banovinën Kroate" (**Uredba o Hrvatskoj Banovini**). Për lindjen dhe zhdukjen e këtij entiteti territorial në rendin kushtetues të ish-Jugosllavisë, cf. më shumë në Dragutin Pavličević, "A review of the historical development of the Republic of Croatia". *GeoJournal* Vol. 38, No. 4, (April 1996), fq. 381-391.

(1385-1791). Në favor të faktit se nocioni unionit është jopreciz dhe i gjerë flet edhe fakti se disa shtete me rregullim konfederal ose federal, në emërtim kanë pasur fjalën union. I tillë ka qenë rasti, ta zëmë, me **Unionin e Utrehtit** (1579-1795), i cili në fakt ka qenë republikë holandeze e formës konfederale, e përbërë nga shtatë provinca. Një dëshmi të njëjtë paraqet edhe **Bashkimi Evropian** (BE), që është bashkësi politike e shteteve të pavarura, një bashkësi huazishtetërore dhe mbishtetërore, pa kushtetutë, me disa karakteristika të federatës dhe konfederatës, dhe mban emrin union.

3.1.1. Unioni personal

Unioni personal është bashkësi politike e shteteve të pavarura që kanë sundimtarin e përbashkët. Këto forma më të lira të lidhjes ndërkombëtare kanë qenë të shumta përgjatë historisë, kurse sundimtari njëjtë ka qenë mbret ose perandor. Një përjashtim nga kjo rregull është rasti i **Simon Bolivar** (Simon Bolivar: 1783-1830), i cili ka qenë president i dy republikave, Venezuelës dhe Grenadës së Madhe, para shkrirjes së tyre më 17 dhjetor 1819 në një republikë - **Kolumbia e Madhe**. Nga kjo kohë, ai ka shërbyer njëkohësisht si president i **Kolumbisë së Madhe** (1819-1830) dhe si **diktator i Perusë** (1823-1826). Me dhjetëra shtete përgjatë historisë kanë qenë në unione personale, duke krijuar lidhje kryesisht të lira juridiko-kushtetuese. Unionet nuk janë krijuar me kushtetuta, sepse ato nuk kanë ekzistuar, por shtetet anëtare kanë lidhur marrëveshje mes veti, e cila sot do të kishte karakterin e marrëveshjes ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, mundësia për të hyrë në union shtetëror është bazuar në një vendim politik, i cili është dashur të ketë bazën në të drejtën e brendshme. Ky kusht nuk ka ekzistuar nëse deri të formimi i unionit personal ka ardhur përmes okupimit (okupimi italian i **Shqipërisë** më 1939). Unionet personale janë krijuar edhe përmes veprimit të së drejtës trashëguese në oborrin mbretëror, kur pasardhësi i përbashkët i dinastive sunduese ka trashëguar kurorën mbretërore njëkohësisht në disa mbretëri.

Titullari i unionit përfaqëson elementin unifikues dhe është shef i secilit prej anëtarëve të unionit, gjë që shprehet edhe titullin zyrtar të sundimtarit, duke përfshirë krejt shteteve anëtare të unionit dhe veprimtaritë. Kështu, ta zëmë, sundimtari i dinastisë së **Habsburgëve** ka qenë: perandor i Austrisë, mbret i Hungarisë dhe Çekisë, princ i Transilvanisë, dukë i Lorenës. Pozita e tij dhe kompetencat varen nga aktet më të larta juridike të shteteve anëtare. Shtetet anëtare janë të pavarura, kanë organet e tyre të pushtetit dhe rendin juridik, gjithashtu udhëheqin politikën e tyre ndërkombëtare. Ato zakonisht nuk kanë ndonjë garancion reciprok për ndihmë dhe mbrojtje në rast sulmi nga një vend i tretë. Mbijetesa e unionit dhe anëtarëve të saj varet nga vullneti politik i shtetit anëtar. Me daljen nga unioni, shteti do të bëhej i pavarur, ose do të futej në një formë tjetër shtetërore, me një vend tjetër ose më anëtarin e njëjtë të unionit.

Janë të shumta bashkësitë politike që për një kohë të caktuar në të kaluarën kanë pasur sundimtarin e njëjtë, por në të cilat nuk kanë hyrë shtetet e pavarura. Të tilla kanë qenë, ta zëmë: **Polonia**, e cila ka pasur të përbashkët sundimtarin me Rusinë, Hungarinë dhe Boheminë (Çekinë), Lituaninë, Saksoninë; **Hungaria**, e cila ka pasur sundimtarin e njëjtë me Austrinë, Boheminë (Çekinë), Kroacinë, Perandorinë e Shenjtë Romake; **Rusia**, e cila ka pasur sundimtarin e njëjtë me Finlandën përgjatë viteve 1809-1917); **Danimarka** me **Islandën** (1918-1944); **Holanda** me **Luksemburgun** (1815-1890); **Belgjika** me **Kongon** (1885-1905). Sot union personal mund të quhet **Komonveliti i Kombeve** ("Commonwealth of Nations"), i formuar nën kurorën britanike, me 53 anëtarët e vet në fillim. Në krye të tij qëndron mbreti **Çarls i Tretë** (dikur mbretëresha **Elizabetë e Dytë**), i cili në të njëjtën kohë është shef nominal i 16 shteteve anëtare (Britania e Madhe plus 15 shtete), të cilët në këtë mënyrë përbëjnë unionin personal. Kështu, ta zëmë, Kanada është monarki parlamentare, në krye të së cilës formalisht gjendet mbreti britanik, në emër të të cilit pushtetin nominal e ushtron guvernatori i Kanadasë (**Governor General of Canada**).

3.1.2. Unioni real

Unioni real është bashkësi politike e formës së përbërë, në të cilën shtetet e pavarura, si subjekte të barabarta politike, themelojnë lidhjen e tyre shtetërore për shkak se kanë ndonjë interes të përbashkët. Edhe në këtë lidhje shtetërore, shtetet anëtare ruajnë lirinë e hyrjes dhe daljen nga ajo. Ky union, megjithatë, është më i fortë se **unioni personal**. Këtu lidhet një marrëveshje mes shteteve anëtare lidhur me atë se cilat punë kryhen së bashku dhe në çfarë mënyre (ta zëmë, aktualisht ekziston unioni mes **Zelandës së Re** dhe **Ishujve Kuk** në Pacifikun jugor). Zakonisht merret që punët e përbashkëta që i kryen unioni real në emër të shteteve anëtare kanë të bëjnë me sa vijon: mbrojtjen (ushtrinë), punët e jashtme dhe financat. Kjo nënkupton se në raport me vendet e treta, unioni paraqitet si subjekt unik, si shtet. Në të njëjtën kohë, unioni real ka të përbashkët sundimtarin. Si shembull i tillë përmenden: Suedia dhe Norvegjia (181401905), **Austro-Hungaria** (1816-1918), Danimarka dhe Islanda (1918-1944). Këto mund të konsiderohen unionet reale klasike. Nga kjo që u tha mund të thuhet se unioni real ka këto karakteristika të përbashkëta themelore:

- sundimtari i përbashkët, sepse në të kaluarën unionet reale janë lajmëruar si bashkësi monarkike;
- në marrëdhëniet ndërkombëtare unioni paraqitet si subjekt unik juridiko-ndërkombëtar, thjeshtë ai vepron si një shtet, nëse ka marrë mbi vete me marrëveshjes kryerjen e funksione në sferën e politikës së jashtme
- funksionet e përbashkëta të anëtarëve të unionit real ushtrohen (kryhen) në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare; dhe, së fundit,
- anëtarët e unionit real ushtrojnë (kryejnë) në mënyrë të pavarur funksionet vetjake (në rend të parë ligjvënien, gjyqësinë dhe administratën; disa punë, megjithatë, mund të ushtrohen (kryhen) në mënyrë uniforme për krejt unionin, por gjithnjë në bazë marrëveshjes së përbashkët mes anëtarëve.

Mund të futen në grupin e unioneve reale, me disa rezerva, edhe format e lidhjeve mes shteteve që formohen me qëllim të realizimit (kryerjes) së punëve **vetëm në një fushë shoqërore**. Ato janë: fusha monetare, fusha doganore dhe fusha ushtarake. Shtet anëtare ruajnë pavarësinë e tyre, kanë rregullim të brendshëm të ndërtuar sipas kushtetutës vetjake dhe ngelin subjekte të plota të së drejtës ndërkombëtare.

Te **unioni doganor**, bëhet fjalë për bashkësinë e shteteve që kanë krijuar unionin me qëllim të ndjekjes së politikës dhe punëve të përbashkëta doganore. Kjo nënkupton se qarkullimi i mallrave dhe shërbimeve mes shteteve anëtare nuk i nënshtrohet doganave dhe kufizimeve doganore dhe që shkalla e doganës është e përbashkët ndaj vendeve të treta. E tillë është BE-ja, pastaj unioni mes Armenisë, Bjellorusisë, Rusisë dhe Kazakistanit (e formuar në vitin 2015).

Te **unioni monetar**, bëhet fjalë për lidhjen e shteteve, në të cilën ekziston politika e përbashkët monetare dhe emetuese si dhe valuta e përbashkët (ose valutat e lidhura) për shtetet anëtare. Ka ekzistuar dikur unioni monetar skandinav (kruna si valutë: 1873-1914), unioni monetar mes Belgjikës dhe Luksemburgut (franga si valutë: 1922-2002) dhe, më e madhja është, unioni monetar i BE-së, me 28 shtetet anëtare dhe me euron si valutë.

Së fundi, lloj i posaçëm i unionit real është **unioni ushtarak**, si një lidhje që formohet mes shteteve që kanë interes për të vënë nën komandë operative të përbashkët forcat e tyre ushtarake. Në këtë lloj të unionit real hyn **NATO-ja** dhe dikur lidhja ushtarake e ish-vendeve komuniste, e njohur si **Pakti i Varshavës** (1955-1991). Një lloj i unionit real është edhe **Organizata e Sigurisë Kolektive**, që e ka themeluar Rusia në vitin 2003 me gjashtë ish-republikat sovjetike.

3.1.3. Bashkimi Evropian

Një formë krejtësisht e veçantë e bashkësisë politike, me natyrë juridiko-kushtetuese të ndërlikuar, përfaqëson BE-ja. Ideja e bashkimit politik të Evropës dhe vendeve të saj është shekullore. Nga traktatet e kristianëve të shek. XV, ideja e Shteteve të Bashkuara të Evropës e **Viktor Hugo** (Victor Hugo: 1802-1885),[10] Panevropa e **Rihard Kalegri** (Richard Nikolaus Eijiro, Count of Coudenhove-Kalergi: 1894-1972),[11] Unioni Shteteve të Evropës e **Uinston Çurçill** (Winston Churchill: 1874-1965),[12] dhe deri te bashkësitë konkrete politiko-ekonomike, siç janë: **Bashkësia për Qymyr dhe Çelik** (1951), **Bashkimi Ekonomik Evropian** (1957), **Bashkimi Evropian** (1975), kontinenti i vjetër ka arritur në **BE**-në aktuale në vitin 1993. BE nuk është shtet (projekti për një kushtetutë evropiane ka dështuar në vitin 1995), por si një bashkësi politike e shteteve sovrane dhe të pavarur ka disa karakteristika të **unionit real**, **konfederatës** dhe **federatës**. Këto cilësi bazohen në modelin e sovranitetit të ndarë mes BE-së dhe shteteve anëtare. Cilësitë e BE-së, në rend të parë, konsistojnë në atë se ajo përfaqëson një union doganor dhe pjesërisht një union monetar dhe, në kuadër të NATO-s, edhe një union ushtarak (me përjashtime të disa shteteve anëtare që nuk bëjnë pjesë në dy format e fundit të unionit). BE karakterizohet, së dyti, nga një lëvizje e lirë e njerëzve, mallrave dhe shërbimeve dhe kapitalit, gjë që flet për interesin e përbashkët politiko-ekonomik të vendeve anëtare, karakteristikë kjo e unionit real. Së treti, për shkak se BE-ja ka tri organe kryesore të pushtetit: ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, kurse shumica e organeve të pushtetit politik vendos me shumicë votash mbi çështjet siç janë: bujqësia, tregtia, mbrojtja e ambientit jetësor etj., BE-ja përbën elemente të federatës. Fakti që disa prej vendimeve merren me konsensusin e vendeve anëtare, siç është rasti me pranimin në BE të anëtarëve të rinj, flet në favor të tezës se ky organizëm evropian ka elemente të konfederatës.[13] Në favor të rregullimit konfederal flet edhe kompetenca ekskluzive e shteteve anëtare të BE-së në rregullimin e marrëdhënieve shoqërore, siç janë: punët e brendshme (policia), gjyqësia, politika sociale. Në fund fare, shënojmë se hyrja në BE bëhet me shprehjen e vullnetit të shtetit, pas plotësimit të një sërë kushtesh që diktohen nga vetë BE-ja, si dhe me pëlqimin e vendeve anëtare. Dalja nga BE-ja bëhet gjithashtu me vullnetin e shprehur të shtetit, siç ka qenë rasti me **Britaninë e Madhe**, e cila më 2017 nisi procesin e daljen nga BE-ja, i njohur si **BREXIT**, dhe përmbylli atë më 31 janar 2020 në orën 23:00.

3.2. Konfederata

Me nocionin konfederatë nënkuptohet shoqatat, organizatat dhe institucionet nga fushat e ndryshme shoqërore, me qëllim të veprimit dhe mbrojtjes së përbashkët. Të tilla janë, ta zëmë, konfederatave e

---

[10] Si kryesues i **Konferencës së Paqes në Paris**, organizuar pas vlimeve revolucionare në Evropë në vitin 1848, **Viktor Hugo** mbajti një fjalim të zjarrtë para një audience ndërkombëtare, ku shpalosi idenë e tij mbi shtetet e bashkuara të **Evropës**. Fjalimi u mbajt më 21 gusht 1849. Në këtë fjalim, mes tjerash, ai tha se Shtetet e Bashkuara të Evropës, përmes lidhjeve të tyre komerciale e kulturore do të ndikon mbarë botën. Cf. më shumë në Angelo Metzidakis, "Victor Hugo and the Idea of the United States of Europe". *Nineteenth-Century French Studies* Vol. 23 No. 1/2 (Fall-Winter 1994-95), fq. 72-84.

[11] Autori ka marrë inspirimin e tij nga shkalla e tragjedisë së **Luftës së Parë Botërore** dhe përbën trajtimin e rrallë borgjez kundër nacionalizmit të kohës, veçanërisht në Gjermaninë vajmariane por edhe gjetiu nëpër Evropë. Kjo ide e tij ka qenë mjaft aktuale mes dy luftërave botërore. Cf. më shumë në Daniel C. Villanueva, "Richard von Coudenhove-Kalergi's "Pan-Europa" as the Elusive "Object of Longing". *Rocky Mountain Review of Language and Literature* Vol. 59 No. 2 (2005), fq. 67-80.

[12] Ky fjalim është mbajtur në **Universitetin e Zyrihut** (Zvicër), 19 shtator 1946. Ideja e tij është kushtëzuar nga tragjedia dhe tmerret e **Luftës së Dytë Botërore**, me bindjen se një Evropë e bashkuar do të përbënte një barrierë të fortë kundër përsëritjes së tragjedive të tilla në botë. Këtë ide, megjithatë, ai e ka braktisur nga vitit 1951 e tutje. Cf. më shumë në Wendell R. Mauter, "Churchill and the Unification of Europe". *The Historian* Vol. 61 No. 1 (Fall 1998), fq. 67-84.

[13] Rasti me i shprehur i konsensusit në BE është vendimmarrja në **Këshillin Evropian**: vendimet në këtë organ merren me konsensus përveç rasteve kur traktatet mbi themelimin e BE përcaktojnë ndryshe. Ky përcaktim gjendet në nenin 15 (4) të **Traktatit të BE-së**. Cf. CONSOLIDATED VERSIONS OF THE TREATY ON EUROPEAN UNION AND THE TREATY ON THE FUNCTIONING OF THE EUROPEAN UNION (2010/C 83/01). *Official Journal of the European Union*. Volume 53 (30 March 2010).

sindikatave, konfederata e Amerikës së Jugut në futboll etj. Për gjerësinë e këtij nocioni flet edhe fakti që emrin konfederatë e mban federata e Zvicrës, e cila për shkak të arsyeve të traditës ka ruajtur këtë emërtim që ka lindur në periudhën kur nuk ka qenë i qartësuar në aspektin teorik dallimi mes nocionit të federatës dhe konfederatës. Nocioni konfederatë është përdorur edhe për të përshkruar procesin e zgjerimit të shtetit në territore të reja, ta zëmë konfederata kanadeze në mesin e shek. XIX ("confederation canadienne"). Në këtë seksion, megjithatë, ne flasim për emërtimin konfederatë për të përshkruar një formë të rregullimit shtetëror që është lidhje e shteteve, përkatësisht lidhje mes shteteve sovrane dhe të pavarura. Në këtë kuptim, **konfederata** mund të definohet si një bashkësi politike që lind me anë të aleancës mes dy ose më shumë shteteve sovrane dhe të pavarura, që lidhet përmes marrëveshjes ndërkombëtare mes shteteve sovrane dhe të pavarura, të cilën mund të braktisë njëanshëm dhe kurdo secili prej shteteve anëtare. Këtu, pra, nuk bëhet për **një akt të brendshëm juridik**, por për një **marrëveshje ndërkombëtare**. Nisur nga fakti që shtetet anëtare në një konfederatë ruajnë sovranitetin e tyre, ato ruajnë një të drejtë implicite për shkëputje (secesion). Filozofi politiko-juridik dhe teoricieni i njohur i të drejtës ndërkombëtare, **Emerik de Vatel** (Emmerich de Vattel: 1714-1767), lidhur me këtë, shumë herët ka konstatuar për sa vijon: "Disa shtete sovrane dhe të pavarura mund të bashkohen përmes një konfederate të përjetshme, por pa pushuar së qeni shtet... Argumentimet mes anëtarëve nuk dëmtojnë sovranitetin e tyre".[14]

Kur bëhet fjalë për **konfederatën** si bashkësi politike, çështja parë që shtrohet ka të bëj me atë nëse ajo ka elementet e shtetit (popullsia, territori dhe pushtetit), apo ato i takojnë shteteve anëtare? Në këtë kuptim, thënë ndryshe dhe më konkretisht, pyetja e parë që shtrohet është nëse qytetarët e konfederatës janë **shtetas të konfederatës** ose të shtetit anëtar, i cili ngelet bartës i pushtetit sovran, **cila e drejtë ka epërsi**, kush ka monopolin e ushtrimit të dhunës fizike të aparatit shtetëror dhe, së fundi, **kujt i takon territori**?

Në konfederatë, qytetarët kanë **marrëdhënie juridiko-publike** me shtetin anëtar, sepse janë shtetas të tij. Shtetasit e shtetit anëtar janë bartës të sovranitetit, të cilin e bartin në organet e këtij shteti. Kjo nënkupton se pushtetin sovran e ka shteti anëtar, jo konfederata. Sistemi juridik i konfederatës është një **bashkim i thjeshtë e sistemeve juridike** të shteteve anëtare, sepse ekziston **epërsia e sistemeve juridike** të shteteve anëtare dhe **prezumimi i kompetencës** shkon në favor të tyre, jo të konfederatës. Shtetet anëtare kanë organet e tyre të pushtetit dhe sistemin juridik vetjak, ashtu që **monopoli i dhunës fizike shtetërore** i shërben zbatimit dhe mbrojtjes së sistemit juridike të shteteve anëtare, jo të konfederatës si tërësi. Konfederata nuk ka **territorin** e vet, por territori i saj është një përmbledhje e thjeshtë e pjesëve që u takojnë shteteve anëtare, të cilat, këtë territor, e fusin në konfederatë kur hyjnë në të. Konfederata e humb territorin e anëtarit që del nga ajo, që nënkupton se, për këtë arsye, për konfederatën nuk vlen **parimi i integritetit territorial**, por vetëm për shtetet anëtare.

Përkundër që konfederata nuk është shtet por lidhje e shteteve sovrane dhe të pavarura, ajo megjithatë ka disa cilësi të shtetit. Shtetet anëtare janë **subjekte të së drejtës ndërkombëtare**, por edhe konfederata në raport me shtetet tjera vepron si një subjekt ndërkombëtar, u mor vesh vetëm në ato fusha për të cilat e ka pëlqimin e shteteve anëtare. Konfederata nuk ka **kushtetutë**, nuk ka organe të pushtetit (ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor), por ka organe që në emër të saj dhe në emër të shteteve anëtare kryejnë punët e caktuara, të cilat zakonisht kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe raportin me shtetet tjera në të drejtën ndërkombëtare. Cilat **organe të pushtetit në konfederatë** do të ekzistojnë konkretisht, një gjë e tillë përcaktohet me marrëveshjen për themelimin e konfederatës. Ato zakonisht janë **kuvendi i konfederatës**, anëtarët e të cilit janë të deleguar nga shtetet anëtare, jo të zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ana e qytetarëve të tyre. Shtetet anëtare delegojnë numër të barabartë të përfaqësuesve të tyre në këtë kuvend, i cili ka emërtime të ndryshme, të cilët votojnë në mënyrë të njëtrajtshme si delegacion (**en bloc**), bazuar

[14] Emmerich de Vattel, *The Law of Nations* (1758), cituar në Gordon Wood, *The Creation of the American Republic 1776–1787* (University of North Carolina Press: Chapel Hill, 1969), fq. 355.

në instruksionet e detyrueshme nga qendra. Konfederata mund të ketë edhe një **këshill të ministrave** (qeveri), i cili gjithashtu duhet të ketë përbërje të barabartë të shteteve anëtare, dhe që më së shpeshti merret me punët e jashtme dhe mbrojtjen.

Krahasuar me federatën, konfederatat nuk janë bashkësi të përhershme politike, por forma kalimtare, të dobëta dhe të lëkundura.[15] Njëra prej arsyeve të përkohshmërisë së tyre ka të bëj me mënyrën e vendimmarrjes. Vendimet merren me **konsensus**, pajtim të plotë të të gjitha vendeve anëtare. Kjo nënkupton që, në veçanti kur konfederata ka shumë anëtarë, lehtë mund të vjen deri të bllokimi i vendimmarrjes. Nga konsensusi rrjedh e **drejta e vetos** së anëtarëve të konfederatës. Kjo nënkupton që secili anëtar mund të pengoj marrjen e një vendimi të rëndësishëm në nivel të konfederatës. Kur shteti anëtar, megjithatë, pajtohet me vendimin, atëherë ai duhet ta zbatoj atë në territorin e vet dhe ka detyrim për një gjë të tillë. Kjo është e domosdoshme sepse konfederata nuk ka organe që do të mund ta bënin një gjë të tillë në territorin e shteteve anëtare. Vendimet e konfederatës nuk janë ligje, por akte që kanë karakterin e marrëveshjeve ndërshtetërore, zbatimi i të cilave bëhet nga organet e shteteve anëtare.[16] Në rrethanat e komplikuara shoqërore, nuk është reale të pritet që për çështje të rëndësishme politike të vendoset me konsensus të shteteve anëtare, gjë që bën që konfederata të jetë një praktikë e rrallë e formës shtetërore.

Konfederatat lindin në atë mënyrë që shtetet bashkohen në një aleancë me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së përbashkët nga shtetet e treta. Nga suksesi në arritjen e këtij qëllimi varet edhe krijimi i kushteve për formim të një aleance më të fortë politike mes shteteve anëtare dhe shndërrimin e konfederatës në federatë. Rasti i tillë ka qenë Konfederata e 13 ish-kolonive amerikane, e cila u themelua me **Nenet e Konfederatës** ("Articles of Confederation"), që u miratuan më 777 dhe u ratifikuan më 1781. Kjo u shndërrua në federatë me miratimin e **Kushtetutës së SHBA-së** në vitin 1787 (KAm). Ngjashëm me këtë ka qenë rasti Lidhjes gjermane në vitet 1815-1866 dhe Lidhjes gjermanoveriore të viteve 1866-1871, që u shndërrua në Federatën apo **Rajhun Gjerman** në vitin 1871 (unifikimi gjerman). Ish-**Bashkimi Sovjetik** ka qenë në fillim konfederatë (1917-1922), për t'u shndërruar në federatë në vitin 1922 deri në shpërbërjen e tij në fund të **Luftës së Ftohtë** (1947-1991). Më e njohura nga të gjithat, **Konfederata e Zvicrës** ("Confederatio Helvetica"), fillimisht e përbërë nga tri kantone nga viti 1291, zyrtarisht ka ruajtur emërtimin tradicional konfederatë, por ka kohë që ka elementet e qarta të shtetit federal (nga viti 1848). Këtë emërtim e hasim edhe në Kushtetutën e 18 prillit 1999, aktualisht në fuqi, e cila në nenin e parë liston kantonet që formojnë **Konfederatën e Zvicrës**.

Konfederatat e formuara nga federatat ose, edhe më rrallë, nga shtetet unitare, janë dukuri më e rrallë dhe kanë pasur jetë më të shkurtër. Ka raste kur në procesin e **devolucionit** apo bartjes së pushtetit teposhtë, ndërtimi (krijimi) i konfederatës as që pranohet se po ndodhë një gjë e tillë, ani pse në fazën e fundit të shpërbërjes së federatës kjo bëhet e dukshme. I tillë ka qenë rasti me ish-Jugosllavinë, e cila pas vitit 1974 ka marrë elemente të qarta dhe të theksuara të konfederatës, për t'u shpërbërë në pranverë të vitit 1992. Përtej kësaj, njëri prej shteteve trashëgimtare, **RFJ**, e themeluar nga diktatori serb **Slobodan Millosheviq** (Slobodan Milošević: 1941-2006), mori elemente edhe më të theksuara konfederale. Kur u shpërbë në vitin 2006, pas pavarësimit të **Malit të Zi**, kjo strukturë shtetërore, qartë ishte kthyer në një union mes dy shteteve, Serbisë dhe Malit të Zi, me elemente tërësisht konfederale. **Belgjika**, nga një shtet unitar i themeluar në vitin 1831, sot është federatë me elemente të theksuara konfederale: Belgjika u bë e pavarur në vitin 1830, kurse mes viteve 1970-1993, vendi u shndërrua në një strukturë federale; kjo ndodhi përmes gjashtë reformave shtetërore (më 1970, 1980, 1988-1989, 1993, 2001 dhe 2012-2014). Si rezultat i këtyre reformave, neni parë i **Kushtetutës së Belgjikës** (183, me amendamentet e vitit 2014), aktualisht në fuqi, thotë se "Belgjika është shtet federal, i përbërë nga komunitetet dhe

[15] John McCormick, *Understanding the European Union: a Concise Introduction* (Palgrave: Basingstoke, 2002), fq. 6.

[16] Kjo ka qenë karakteristikë themelore që ka dalluar unionit e parë amerikan (1781) nga ai që u themelua me **KAm. Aleksander Hamilton** (Alexander Hamilton: 1757-1804), në **Letrën nr. 15**, mungesën e ligjit të zbatueshëm dhe efektiv në mënyrë të drejtpërdrejtë si një "të metë" dhe si "një ves të madh" në sistemin fillestar kushtetues. Cf. James Madison, Alexander James and John Jay, *The Federalist Papers* (Penguin: Harmondsworth, 1987), fq. 147.

regjionet". **Çekosllovakia** ka qenë shtet unitar në vitin 1918, njëjtë si ish-Jugosllavia që u themelua po atë vit: të dyja u bënë federata pas Luftës së Dytë Botërore. Nga shteti i parë u krijuan dy shtete– **Çekia dhe Sllovakia**, kurse nga e dyta shtatë (Bosnjë-Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia, Sllovenia). Pas Luftës së Parë Botërore, nga perandoria unitare ruse u krijua ish-**BRSS-ja**, i cila në fillim ishte konfederatë për t'u bërë më pas, në vitin 1924, një federatë e centralizuar komuniste nën diktatin e kombit më të madh – rusëve. U shpërbë në vitin 1991, sërish duke poseduar elemente konfederale në dy vitet e fundit të jetës së saj. Në SHBA, nga shtet e jugut u formua konfederata që nuk u njoh asnjëherë gjerësisht, për t'u shpërbërë gjatë **Luftës Civile Amerikane** (1861-1865).

Sa i përket sistemeve politike të shteteve anëtare, ato mund kenë forma republikane ose monarkike të qeverisjes. Ato që kanë formë republikane (republikat e konfederauara), zakonisht quhen **shtete**, siç kanë qenë shtetet e Konfederatës Amerikane (1861-1865), ose thjeshtë **republika**, siç kanë qenë republikat e Malit të Zi dhe Serbisë brenda **BSHSMZi** (2003-2006). Ato që kanë formë monarkike të qeverisjes (monarkitë e konfederauara), definohen sipas rangjeve të ndryshme të hierarkisë, siç ka qenë rasti me mbretëritë e Irakut dhe Jordanisë brenda **Unionit Arab Hashemit** (1958), një bashkësi shtetërore konfederale jetëshkurtër, që në emërtim ka qenë federatë.

4. Federata

E kundërt me lidhjen e shteteve, të diskutuara më sipër, **federata** është **shtet i lidhur** dhe, praktikisht, forma e vetme e shtetit të përbërë. Rregullimi kushtetues i marrëdhënieve mes shtetit dhe pjesëve të saj përbërëse, federatës dhe njësive federale, është treguar si model i suksesshëm në veçanti për shtetet që kanë hapësirë dhe popullsi të madhe. Në këtë kuptim, ky rregullim shtetëror burimin e vet teorik e merr nga filozofët politikë të shekujve XVI, XVII dhe XVIII, me fillim nga **Zhan Bodin**, **Xhon Lok**, **Tomas Hobes**, **Monteskie** dhe **Ruso**, por edhe te ata të antikitetit, si **Aristoteli**, të cilët kanë sugjeruar formën republikane të shtetit si të përshtatshme për shtetet me vëllim të madh të territorit dhe popullsi të madhe. Kjo formë ka qenë e barasvleshme me shtetin federal në kuptimin bashkëkohor të fjalës, por edhe me demokracinë si dukuri shoqërore. Ky koncept iu ka kundërvu konceptit të shtetit monarkik, që ka qenë i barasvlefshëm me shtetin absolut dhe jodemokratik, meqë origjina e pushtetit ka qenë hyjnore dhe është ushtruar në emër të hyjnisë. U mor vesh, në kohën e sotme këto nocione nuk janë kuptimisht të njëjta dhe përfaqësojnë gjëra të ndryshme dhe më shumë i takojnë sferës së politologjisë, ku studiohen regjimet politike, llojet e tyre dhe fenomenet tjera shoqërore që lidhen me to.

Shteti modern, **shteti-komb** (apo shteti vestfalian, siç quhet ndryshe), me formën e vetë legale substancialisht unitare, është krijuar dhe ndërtuar krahas dhe në interkasion kompleks me **federatën** dhe **perandorinë** – dy forma të bashkësive politike, të cilat, përkundër krejt dallimeve, kanë të përbashkët logjikën e brendshme shumë pluraliste. Të dyja janë unione apo bashkësi të shteteve, të një natyrë skajshmërisht të ndryshme. Federatat bazohen në pëlqimin e shteteve, njësive federale, kurse perandoritë bazohen në forcë dhe okupim, ku qendra dominon dominionet ose periferinë. Paradoksalisht, një perandori lejon më shumë diversitet brenda sferës së vet të dominimit, kurse federata kërkon më shumë homogjenitet mes anëtarëve të vet.[17]

4.1. Federalizmi

Federalizmi është një kuptim i gjerë dhe nuk lidhet vetëm me rregullimin shtetëror, për shkak se nënkupton çdo formë të lidhjes së njësive autonome. Në të drejtën kushtetuese, federalizmi është lidhja dhe bashkimi i lirë i subjekteve politik mbi bazën e të cilit formohet shteti federal si bashkësi politike e qytetarëve dhe bashkësive politike – anëtarëve të federatës. Marrëdhënia mes anëtarëve të federatës si shtet

[17] Cf. më shumë në Olivier Beaud, "Federation and empire: About a conceptual distinction of political forms". *International Journal of Constitutional Law* (2018), Vol. 16 No. 4 (2018), fq. 1199–1206.

dhe njësive të saj federale mund të jetë e **marrëdhënie e natyrës së fortë** dhe **marrëdhënie e natyrës së dobët**. Kjo marrëdhënie shkon nga ajo në të cilën njësitë federale kanë shumë të drejta, të përafërta me anëtarët e një konfederate, deri te shteti i fortë federal në të cilin federata kryen punët më të mëdha dhe më të rëndësishmet, kurse pushteti që ngelet ushtrohet nga njësitë federale.

Rrënja e fjalës federatë gjendet në shprehjen latine **foedus**, që nënkupton aleancë. Në këtë kuptim, qysh në kohën antike kanë ekzistuar aleancat politike që kanë pasur cilësi të ngjashme me federatat e sotme. Në **Greqinë** antike kanë ekzistuar aleancat mbrojtëse, që kanë nënkuptuar ushtri dhe mbrojtje të përbashkët. Ndër to më të njohurat kanë qenë **Lidhja Deliane**, formuar më 478 p.e.s. nën patronatin e Athinës, dhe **Lidhja Akeane**, formuar në kohën helene në **Peloponezin** verior dhe qendror, në shekullin pesë p.e.s. (lidhja e parë) dhe në vitin 280 (lidhja e dytë), për t'u shkatërruar nga romakët në vitin 146 p.e.s. Në **Mesjetë** kanë ekzistuar lidhje e aleanca ushtarake e mbrojtëse të qyteteve, principatave, dukatave, shoqërive të ndryshme etj., por që asnjëra nga këto nuk mund të konsiderohen paraardhëse të federatave të sotme. Federatë e parë janë **SHBA-ja**, e cila u krijua në rrethanat konkrete politike, pas fitores kundër kolonializmit britanik dhe kompromisit reciprok mes ish-kolonive britanike. Mes opsioneve që kanë shkuar nga lidhja e lirë e tipit konfederal deri te lidhja më e fortë në një shtet unitar, rregullimi federal u përqafua si zgjidhje ndërmjetme. Si konfederal ka ngelur vetëm emri shtetit amerikan-Shtetet e Bashkuara, pra jo "shteti i bashkuar".[18]

Nevoja, por edhe domosdoshmëria, për rregullim federal rrjedh nga fakti që shoqëritë politike nuk janë monolite, sepse brenda tyre ekzistojnë dallime që sistemi kushtetues duhet t'i marrë parasysh. Ato dallime janë të natyrës gjeografike, klimatike, kulturore, ekonomike, nacionale/etnike, tradicionale dhe të tjera dallime që janë aq të mëdha sa pamundësojnë barazimin/uniformitetin e tërësishëm shoqëror dhe juridik të bashkësive politike. Kjo nënkupton që shprehja e ndërlikueshmërisë së dallimeve të tilla nuk mund të bëhet përmes rregullimit dhe kontrollit me struktura të njëjta normative (kushtetutë, ligje dhe norma të njëjta) dhe nga e njëjta qendër. Pikërisht marrja parasysh e dallimeve dhe interesave të ndryshme ka çuar në formimin e federatës së parë në botë dhe, me këtë, ka ardhur deri te plotësimi i kushtit themelor të mbijetesës dhe funksionimit deri në ditët tona. Nga të njëjtat arsye, përkatësisht **shkaku i ekzistimit të dallimeve**, të cilat nuk mund të qeverisen dhe as nuk mund të drejtohen në mënyrë të njëjtë, kanë lindur edhe federatat e sotme.

Federatat kanë **edhe një arsye tjetër të formimit**, e cila vlen në masë të madhe edhe për të gjitha lidhjes shtetërore (unionet dhe konfederatat). Ajo arsye konsiston në atë se **liria politike** mund të mbrohet më lehtë në shtete të mëdha e të forta, pjesët e të cilave janë të lidhur fort ndërmjet vete, sesa në shtete të vogla e të dobëta që përgjatë historisë janë treguar të paqëndrueshme dhe të dobëta. Epërsia e vërtetë e federatës qëndron pikërisht në madhësinë dhe fuqinë e shtetit federal, e cila ruan dhe kultivon, pra nuk kufizon lirinë e shumësisë së diversiteteve. Pikërisht ajo që mund të duket dhe të tingëllojë si një paradoks,–që shteti i fuqishëm mban dhe ruan diversitetin e pjesëve të tij të vogla –përbën njërën ndër cilësitë dhe virtytet kryesore fillestare të federatës. Për këtë arsye edhe definohet si bashkësi e të kundërtave: federata është unitet përmes shumësisë, bashkësi shtetërore pa rregullim të brendshëm të pandashëm, tërësi pa uniformitet, union pa unitarizëm.[19]

---

[18] Cf. më shumë në Harry N. Scheiber, "Federalism and Legal Process: Historical and Contemporary Analysis of the American System". *Law & Society Review* Vol. 14, No. 3, Contemporary Issues in Law and Social Science (Spring, 1980), fq. 663-722.

[19] Cf. më shumë në Sharda Rath, "Federalism: A Conceptual Analysis". *The Indian Journal of Political Science* Vol. 39 No. 4 (Oct-Dec. 1978), fq. 573-586; Ronald L. Watts, "Federalism, Federal Political Systems, and Federations" *Annual Review of Political Science* Vol. 1 (1998), fq. 117-137; Anna Gamper, "A Global Theory of Federalism": The Nature and Challenges of a Federal State". German Law Journal Vol. 6 No. 10 (2005), fq. 1297-1318; Frédéric Lépine, "A Journey through the History of Federalism Is Multilevel Governance a Form of Federalism?" *L'Europe en Formation* Vol. 1 No. 363 (2012), fq. 21-62; Ernest Young, "Federalism as a Constitutional Principle". *University of Cincinnati Law Review* Vol. 83 No. 4 (August 2015), fq. 1057-1082.

Federata nuk është formë e përkryer e rregullimit shtetëror dhe as nuk i përgjigjet çdo bashkësie politike dhe shoqërisë së saj. Edhe aty ku është ndërtuar një federatë funksionale, nuk janë tejkaluar të gjitha konfliktet dhe mosmarrëveshjet shoqërore. Ato vazhdojnë të ekzistojnë, por intensiteti i tyre, pikërisht për shkak të aftësisë së federatës për përshtatje ndaj tyre, në të shumtën e kohës nuk është i natyrës së atillë sa të rrezikoj shtetin dhe të frenoj zhvillimin e tij. Anët negative të federatës, për aq sa ekzistojnë, kanë të bëjnë, para së gjithash, me nxitjen e përpjekjeve dhe synimeve separatiste në shoqëritë me përbërje nacionale heterogjene. Në parim, dhe bazuar në përvojën historike, federata mbron specifikat de dallimet nacionale, ashtu që vështirë se mund të jetë e suksesshme në krijimin e një kombi të vetëm, në kuptimin politik, jo në kuptimin etnik. Përjashtim nga kjo paraqet rasti i SHBA-së, e cila ka arritur të krijoj kombin amerikan në kuptimin politik të fjalë për përbërjet etnike skajshmërisht heterogjene. Kjo federatë cilësohet si "kazani shkrirjes" ("melting pot"), për të përshkruar lindjen e kombit amerikan nga emigrantët e gjeneratës së dytë dhe të tretë.[20] Kjo tregon (flet) për vitalitetin e shtetit për asimilim dhe absorbim paqësor dhe me vullnet të çdo diversiteti, në rend të parë të atij etnik dhe gjuhësor, që nuk është rasti me shtetet tjera. Kështu, ta zëmë, **Federata e Rusisë** ngërthen në veten e saj dhjeta bashkësi etnike e fetare të ndryshme nga populli rus, të cilat, përkundër që flasin gjuhën ruse, si dhe synimeve të vazhdueshme të Moskës për asimilim të tyre të dhunshëm, kanë arritur të ruajnë identitetin e tyre origjinal. Ky diversitet, në fakt, reflektohet edhe në **Kushtetutën e Federatës së Rusisë** (1993), aktualisht në fuqi, e cila fjalinë e parë të preambulës së saj e nis me: "Ne, populli multinacional i Federatës së Rusisë".

4.1.1. Arsyet për themelimin e federatave

Përbërja **shumënacionale** e popullsisë në një shtet konsiderohet si njëri ndër arsyet kryesore për themelimin e shtetit me rregullim federal. Në shtetin unitar, pakicat kombëtare nuk janë çdoherë të kënaqura me pozitën e tyre dhe shkallën e autonomitetit në vendimmarrje. Kjo forcon tensionet ndërnacionale dhe përpjekjet e synimet separatiste, të cilat potencialisht paraqesin rrezik për ekzistencën e shtetit. Me ndryshimin e rregullimit shtetëror në rregullim federal ndryshohet statusi kushtetues, të drejtat politike dhe të drejtat tjera të bashkësive nacionale dhe zvogëlohen përpjekjet dhe synimet e tyre për shkëputje. Në këtë mënyrë ruhet integriteti i shtetit. Kjo vlen edhe atëherë kur baza e diversitetit dhe dallimit qëndron në religjion, gjuhë, kulturë, vendndodhje gjeografike dhe baza të tjera të dallimit mes popujve të federatës. Sipas parimit të simetrisë nacionale (dhe tjetër), secili komb apo popull shtetformues fiton njësinë e vet federale dhe merr pjesë në mënyrë të barabartë me të tjetër në ushtrimin e pushtetit federal, kurse në mënyrë të pavarur rregullon organizimin dhe drejton njësinë e vet federale.

Në këtë mënyrë është krijuar ish-**Jugosllavia** në vitin 1946, pjesë e së cilës ka qenë Kosova: Kushtetuta e vitit 1946 e **Republikës Federale Demokratike të Jugosllavisë** (RDFJ) ka normuar një rregullim shtetëror federal, për dallim nga Mbretëria e Jugosllavisë (1918-1943), e cila ka pasur rregullim shtetëror unitar. **RFDJ-ja** në fillim ka pasur pesë njësi federale të formuara sipas karakteristikave kombëtare, apo republika (Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia, Sllovenia), dhe një republikë që ka pasur karakteristika të përziera apo multikombëtare (Bosnjë-Hercegovina). Bashkësitë më të vogla politike, të ndryshme për nga përbërja nacionale dhe tjetër, bashkohen në federatë, duke formuar brenda federatës njësinë e tyre federale, në të cilën përfshihet pjesa më e madhe apo krejt kombi ose populli me cilësi të njëjta kombëtare, fetare, gjuhësore dhe të tjera. Kështu, ta zëmë, frankofonët e **Kvebekut**, pjesëtarët e emigrantëve francezë që janë vendosur në këtë provincë, së bashku me provincat tjera koloniale është bashkuar në **Kanada**. Si federata shumënacionale mund të konsiderohet ish-vendet evropiane, si: **Jugosllavia**, **Bashkimi Sovjetik** dhe Çekosllovakia. Të tilla janë akoma vendet si: Belgjika, Federata

[20] Në sociologji, **kazani shkrirjes** është një koncept që i referohet një shoqërie heterogjene, duke u bërë më homogjene me elementët e ndryshëm të "shkrirë së bashku" në një tërësi harmonike me një kulturë të përbashkët. Koncepti i **tenxhere e shkrirjes** përdoret më së shpeshti për të përshkruar asimilimin e emigrantëve në Shtetet e Bashkuara, megjithëse mund të përdoret në çdo kontekst ku një kulturë e re vjen për të bashkëjetuar me një tjetër. Në kohët e fundit, refugjatët nga **Lindja e Mesme** kanë krijuar enë të shkrirjes në të gjithë Evropën dhe SHBA. Ky term shpesh sfidohet nga ata që pohojnë se dallimet kulturore brenda një shoqërie janë të vlefshme dhe duhet të ruhen. Një metaforë alternative, pra, është sallatë salloni ose mozaik, duke përshkruar se si kulturat e ndryshme përzihen, por ende mbeten të dallueshme.

Ruse, India, Kanada, Zvicra. Me këtë rast, duhet shënuar se për themelim të federatës, nuk është kusht i domosdoshëm që secili komb apo popull të ketë njësinë e vetë federale. Mjafton që disa njësi federale, së paku dy, të formohen sipas kriterit nacional (**simetria e pjesshme nacionale**). Ky kriter, siç u tha, mund të bazohet edhe në dallimet tjera, siç janë **gjuha** (Belgjika, Zvicra), **feja** (Federata Ruse, India) etj.

Në lindjen e federatës mund të hetohen **faktorë të ndryshëm historikë**. Këtu hyjnë rrethana të caktuara politike, të brendshme dhe të jashtme, të cilat në një moment të dhënë kohor kanë çuar deri te bashkimi i bashkësive politike të pavarura ose gjysmë të pavarura në federatë. Këtu zakonisht bëhet fjalë për shtete që kanë pasur zhvillim të ngjashëm historik që ka kontribuar në ekzistimin e lidhjeve dhe ndikimeve reciproke mes popujve të tyre, kulturës, gjuhës dhe zakoneve respektive. Koha e kaluar bën që lidhja më e fortë politike, kulturore, ekonomike dhe tjetër të çojë në lindjen e federatës. Përmes një agregacioni të tillë ka lindur **Zvicra** e sotme, e nisur në vitin 1291 nga tri kantone: **Uri** (Uri), **Shviz** (Schwyz) dhe **Untervalden** (Unterwalden). Këto kantone kanë pasur lidhje konfederale mbrojtëse, për të mbrojtur vetveten nga sundimi **Habsburg**. Në revolucionin e vitit 1848 dhe pas bashkëngjitjes së kantoneve të tjera, që sot e kësaj dite janë të njëjta, **Zvicra** shndërrohet në federatë. **SHBA-ja**, në fillim ka qenë e përbërë nga trembëdhjetë ish-koloni, të cilat mundën **Britaninë e Madhe** në vitin 1783 dhe e formuan konfederatën. Bërthamën e vet e ka në gjashtë kolonitë e para të **Anglisë së Re**: Main (Maine), Vermont (Vermont), Nju Hemshir (New Hampshire), Massachusetts (Masaqustes), Connecticut (Konektikat) dhe Rode Ajland (Rhode Island). **Gjermania** u krijua pas fitores së Prusisë ndaj Francës më 1871, nga konfederata gjermanoveriore e 22 shteteve. Arsyet pse tri qytetet gjermane, **Berlini**, **Bremeni** dhe **Hamburgu**, sot e kësaj dite janë njësi federale lidhet me shkaqet historike, përkundër asaj që edhe njësitë tjera federale (13 sosh) kanë rrënjë historike, si hapësira unike historike ose si gërshetim i disa territoreve historike që kanë gëzuar pavarësi ose mëvetësi në të kaluarën.

Arsyet gjeografike gjithashtu ndikojnë në krijimin e federatave, përkatësisht të disa prej njësive federale. Si dëshmi për këtë është fakti se prej 10 shteteve më të mëdha të botës, vetëm tri janë federata (Algjeria, Kina, Kazakistani). Ndikimi i faktorëve gjeografikë sikur nënkuptohet kur bëhet fjalë për federalizimin e një shteti. Shteti i madh çdo herë nënkupton dallime në klimë, male, bjeshkë e fusha të gjera dhe të pafund, hapësira të punueshme dhe me ujë të bollshëm. Këto dallime ndikojnë në popullsinë e atyre hapësirave gjeografike, mënyrën e tyre të jetesës, kulturën, si dhe të bërjes ekonomi e biznes. Për këtë arsye, për shtetin më lehtë është të organizoj në mënyrë adekuate administratën në territore të largëta dhe specifike, duke pranuar e përqafuar dallimet dhe specifikat e tyre dhe duke lënë vetëqeverisjen në duart e popullsive vendore. Të një natyre të tillë janë njësitë federale të **Federatës së Rusisë** në **Kaliningrad** në perëndim të vendit, **Murmansk** në veriun e skajshëm rus, **Kamçatka** në lindjen e largët. E njëjta vlen edhe për shtetin e Alaskës në **SHBA**, në cepin më ekstrem të Amerikës Veriore.

Arsyet ekonomike nuk janë mbizotëruese në krijimin e federatave, por përfaqësojnë në rend të parë një shkak të vlefshëm në themelimin e **unioneve reale**. Në rastin e federatave, ato janë një prej arsyeve të lidhjeve federale mes shteteve, kriter për caktimin e kufijve të njësive federale, si tërësi të mbyllura ekonomike. Arsyet ekonomike ndikojnë në rirregullimin e shtetit unitar në shtet federal, sepse me fitimin e një njësie federale synohet dhe theksohet nevoja për zhvillim dhe përparim të ekonomisë ekzistuese federale dhe lidhur me këtë, edhe të të ardhurave financiare. Në këtë kontekst, arsyet ekonomike çdoherë theksohen më shumë në pjesët e pasura të shtetit, që më së shumti përfitojnë nga federalizimi i mëtejmë i pjesëve të caktuara të federatës, sesa në pjesët që kanë ngecje në zhvillim ekonomik (si në industri ashtu edhe në pasuri natyrore). Në rastet kur kushtet për federalizim nuk janë të dukshme dhe të sigurta për një kohë të caktuar, atëherë përpjekjet ekonomike dhe financiare realizohen, si zgjidhje e përkohshme, në nivel të autonomive politiko-territoriale.

Krahas faktorëve dhe arsyeve si më sipër, mund të përmenden edhe disa të tjera si arsye e shkaqe për federalizim të vendit ose për lindjen e njësive të reja federale, siç janë arsyet dhe shkaqet e natyrës **ushtarake** (Sevastopoli në Federatën Ruse), **administrative** (qytetet kryesore, si Berlini, Brukseli, Buenos

Aires, Moska). Fare në fund, theksojmë se arsyet dhe shkaqet për federalizim të shteteve veprojnë së bashku. Trajtimi që u kemi bërë këtu më shumë ka të bëj me didaktikën e shtjellimit dhe sa për të përshkruar ndikimin e secilit shkak dhe arsye veç e veç në mënyrë të ndarë, me qëllim të gjetjes se cilat shkaqe e arsye kanë pasur ndikim sipëror dhe në cilat raste. Me fjalë të tjera, vështirë se mund të përmenden faktorët dhe shkaqet ekonomike si vendimtar në themelimin e një federate, pa marrë në konsideratë gjeografinë dhe administratën si shkas e arsye. Edhe arsyet dhe shkaqet historike, kulturore dhe nacionale veprojnë kryesisht në mënyrë të bashkuar në krijimin e federatave.

4.1.2. Llojet e federatave

Federatat mund të **grupohen në disa grupe**, sipas disa kritereve:

- sipas mënyrës së krijimit;
- sipas përbërjes nacionale;
- sipas ndryshueshmërisë së strukturës; dhe
- sipas përbërjes.

Ndarjet flasin për disa cilësi të caktuara të secilës formë të rregullimit shtetëror dhe kontribuojnë në zbulimin apo shfaqjen e natyrës së tyre juridike.

Sipas **mënyrës së krijimit** dallojmë federatat që krijohen me **agregacion** dhe ato që krijohen me **devolucion**. Në rastin e parë federata krijohet nga lartë poshtë, me marrëveshje të shteteve të pavarura. Kjo nënkupton se federata është shtet i ri në të cilën janë futur disa shtete, së paku dy. Para themelimit të federatës, këto shtete kanë mund të jenë në një bashkësi politike – union ose konfederatë, në raport me të cilat federata është lidhje me e fortë e bashkimit të tyre. Forcimi i mëtejshëm i federatës mund të çoj në unitetin e plotë juridiko-kushtetues të vendit. Forcimi i fuqive centralizuese të federatës, sipas rregullit, shpie në stabilitetin e saj më të madh. Ajo përfaqëson gjendjen politike të situatës së qëndrueshme në shtet, ku pushteti federal është mjaftueshëm i fortë kurse njësitë federale luajale ndaj qendrës (ngelin në federatë) për shkak se kanë ruajtur specifikat e tyre politike dhe pavarësinë juridike. Shumica e federatave janë krijuar me agregacion (Australia, Gjermania, Kanadaja, SHBA-ja, Zvicra).

Devolucioni është proces i kundërt gjatë themelimit të federatës. Devolucioni fillon nga poshtë lartë, që nënkupton se pushteti më i lartë, pushteti qendror, ua bartë niveleve më të ulëta të qeverisjes pushtetin e llojit të caktuar. Këto nivele më të ulëta janë njësi federale me emërtime të ndryshme: republika, shtete, vende, komonvelte, territore, regjione, krahina autonome, qytete federale. Devolucioni nënkupton ndryshimin e rregullimit të brendshëm të shtetit në drejtim të decentralizimit. Ky është një proces centrifugal që zhvillohet në shtetin unitar. Historikisht shikuar, shpërndarja politike mund të merret si vërejtja kryesore ndaj procesit të devolucionit, sepse ai proces, bazuar në përvojën e deritanishme, nuk përfundon në federalizim por në shpërbërjen ose zhdukjen e shtetit në tërësi. Kjo ndodhë shkaku i rritjes së partikularizmit, zakonisht atij nacional, i cili nuk heq dorë nga realizimi i qëllimeve separatiste përmes formimit të njësisë federale, por vazhdon tutje deri në realizimin e shtetit të pavarur dhe sovran. Si shembull i federatës së krijuar përmes devolucionit, nga një shtet unitar deri në krijimin e rregullimit shtetëror federal/konfederal, është Belgjika. Një numër i shteteve që janë krijuar në procesin e devolucionit në të kaluarën, tanimë nuk ekzistojnë. Kemi falën për **Pakistanin** federal, Çekosllovakinë, **Bashkimin Sovjetik**, **Jugosllavinë** komuniste. Federata e krijuar përmes kësaj mënyrë, devolucionit, mund të jetë stabile, siç provon rasti i **Austrisë**.

Sipas **përbërjes së tyre nacionale**, federatat i ndajmë në **shumënacionale** dhe **njënacionale** (homogjene). Meqë parimi i nacionalitetit është njëri ndër shkaqet kryesore ose më të rëndësishme në

procesin e krijimit të federatave, atëherë edhe vetë federatat në të shumtën e rasteve janë shumënacionale. Federatat njënacionale, dhe në përgjithësi shtete homogjene në pikëpamje nacionale, sot janë shumë të rralla. Në këtë kuptim, njënacionaliteti nuk nënkupton që në shtet nuk ekzistojnë kombe ose nacionalitetet të tjera, por që një komb ose një etni është në numër më të madh, ose dukshëm më të madh, në raport me të tjerët.

Federata njënacionale, sipas vetë konceptimit të federatës, del që është kontradiksion i vetë saj, marrë parasysh se federatat në të shumtën e rasteve krijohen pikërisht për shkak se janë shtete shumënacionale (shumetnike). Federatat njënacionale do të mund të grupoheshin në dy grupe. Në grupin e parë hyjnë ato federata ku një komb apo nacionalitet (etni) është numerikisht dukshëm më e madhe se të tjerët, historikisht shikuar. Në këtë grup hyjnë Austria Gjermania, Meksiko. Në grupin e dytë të federatave njënacioanale hyjnë shtet që kanë kombin me të njëjtin emër si vetë shteti, ku kombi krijohet paralel me shtetin por që nuk kanë rrënjë të përbashkëta etnike. Të tilla janë federatat si vijon: **Australia**, **Kanadaja** (nëse përjashtojmë **Kvebekun** frankofon, i cili, megjithatë, konsideron veten si kanadez) dhe **SHBA**.

Federatat shumënacionale janë shtete në të cilat njësitë federale formohen sipas parimit nacional. Kjo nuk do të thotë se parimi nacional është i vetmi në procesin e formimit të njësive federale, por dominues dhe kryesori që vihet në jetë së paku në formimin e disa prej tyre. Në këto federata, të gjitha kombet nuk duhet domosdo të jenë të barabartë numerikisht: njëra prej tyre është dominuese në numër, në shumicë absolute ose relative, në raport me popullsinë e tërësishme të federatës. Në këto federata bëjnë pjesë, ta zëmë, India, Rusia, Zvicra.

Sipas **parametrave juridikë**, federatat paraqiten me **strukturë të ndryshueshme** ose **të pandryshueshme**, janë me **përbërje të thjeshtë** ose **me strukturë të përbërë**. **Struktura e ndryshueshme** e federatës ka të bëj me organizimin e brendshëm, e cila në këto shtete nuk është çdoherë e dhënë dhe e përcaktuar. Kjo nënkupton se federata është e hapur për shtetet tjera si njësi të reja federale, se kufijtë e njësive federale mund të ndryshojnë, se njësitë federale mund të bashkohen ose të ndahen, deri te mundësia e daljes së njësive federale nga shteti federal. Të mundësia e bashkëngjitjes së njësive të reja federale, mund të ekzistojë një dispozitë shprehimore kushtetuese, siç ka qenë rasti, ta zëmë, me nenin 2 të **Kushtetutës së RFJ-së** (Serbi – Mali i Zi) të vitit 1992, që lejonte futjen e shteteve të tjera në këtë shtet, ose mundësia që federata të konsiderohet e hapur përveç situatave kur shprehimisht ndalohet hyrja e njësive të tjera federale. Në një rast të tillë federata do të zgjeronte strukturën e saj në një procedurë të veçantë, por duke ndryshuar kushtetutën e saj.

E drejta e njësisë federale për të dalë nga federata ka ekzistuar dhe ekziston vetëm në një numër të kufizuar të federatave. Si shembull në literaturë përmenden si vijon: **Kushtetuta e Etiopisë** (1994), e cila në nenin e saj 39 përcakton që "[...] secili komb, kombësi, popull ka të drejtën e vetëvendosjes dhe shkëputjes"; **Kushtetuta e Saint Kits dhe Nevis** (Saint Kitts and Nevis) (1983), një komb i përbërë nga dy ishuj, që gjendet në mes të Oqeanit Atlantik dhe Detit të Karaibeve, e cila në nenet e saj 113 dhe 115 përcaktonte një të drejtë të tillë. Në Jugosllavinë komuniste (1945-1992), pjesë e së cilës ka qenë **Kosova**, ka ekzistuar një stipulim kushtetues që njihte "të drejtën e popujve për vetëvendosje deri në shkëputje" (parimet themelore të kushtetutave të viti 1963 dhe 1974 të atij shteti). Nisur nga ajo që kombet e ish-Jugosllavisë kanë pasur njësitë e tyre federale, dilema dhe debati i gjallë tërë kohën sa ka ekzistuar ky shtet ka pasur të bëj me atë nëse kombet përbërëse ose njësitë federale gëzonin të drejtën e vetëvendosjes, përfshirë shkëputjen nga federata. Këtë dilemë e ka zgjedhur një komision ndërkombëtar, i njohur si **Komisioni Badinter**, që u themelua më 1991 dhe ka funksionuar deri më 1993. Në fillim, komisioni ka qenë pjesë e konferencës për Jugosllavinë, e themeluar Bruksel më 27 gusht 1991 nga **BE-ja**, në një kohë që sapo kishte nisur kriza në ish-Jugosllavi. Ky trup profesional, më vonë ka kaluar në kuadër të **Konferencës Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë** (që u themelua në **Londër** në verë të vitit 1992 dhe zgjati formalisht

deri më 1996), në mendimet e veta në mënyrë të vazhdueshme dhe mjaft profesionale ka sqaruar se e **drejta për vetëvendosje të jashtme** i takon vetëm njësive federale, jo edhe autonomive apo entiteteve të tjera që mund të themeloheshin ndërkohë përmes përdorimit të dhunës, siç ishte "Republika Sërpska" në **Bosnjë-Hercegovinë** dhe disa entitete të tjera të ngjashme që serbët i patën formuar me dhunë në procesin e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë (1991-1992). **Komisioni Bandinter** tha se vetëm ish-republikat federale të ish-Jugosllavisë kishin të drejtën e pavarësisë së plotë, të vetëvendosjes së jashtme, kurse krahinat autonome dhe popujt tjerë që kishin ngelë brenda këtyre republikave federale dhe që u bën shtete sovrane dhe të pavarura, kishin të drejtën e vetëvendosjes së brendshme, pra vetëm të drejtën për autonomi, sundim të ligjit, demokraci dhe respektim të të drejtave të tyre individuale dhe kolektive, si prestarë të kombeve të dikurshme që kishin formuar ish-**Jugosllavinë** si shtet.[21] Kjo ka qenë kështu edhe me ish-**Bashkimin Sovjetik**: Kushtetuta e vitit 1977 e këtij vendi, në nenin 70 garantonte të drejtën e popujve për vetëvendosje, por jo në shkëputje. Kjo efektivisht e bënte të pavlefshme këtë dispozitë sepse roli i partisë komuniste ka qenë vendimtar dhe i garantuar me kushtetutë, ashtu që as që ka mundur të paramendohej nisja e shkëputjes ose e realizimit të ndonjë forme të vetëvendosjes së ndonjë kombi ose populli që ka jetuar në atë shtet.

Federatat me strukturë të pandryshueshme janë ato federata ku nuk mund të vjen deri te ndryshimi i organizimit të brendshëm të shtetit federal, qoftë me pranimin e shteteve të reja si njësi federale apo përmes ndryshimit të kufijve të njësive federale por pa ndryshimin e kufijve të jashtëm të shtetit federal. Kjo federatë gjithashtu nënkupton se nuk mund të shkëputet përmes procedurës ligjore një njësi federale, por vetëm me anë të rrugëve faktike. Një hap i tillë i shkëputjes do të nënkuptonte shpallje lufte sepse asnjë njësi federale nuk ka të drejtën e daljes nga ky lloj i federatave, përkatësisht do të nënkuptonte kryengritje ose revolucion, siç e ka thënë **Abraham Linkoln** (Abraham Lincoln: 1809-1865) me plot të drejtë kur ka përshkruar legjitimitetin e qeverisë. Ai këtë mendim e ka shprehur në adresimin e parë inaugurues si shef i shtetit më 4 mars 1861, duke thënë, **inter alia**, se "[...] Ky vend, së bashku me institucionet, i takon popullit që banon në të. Çdo herë kur populli mërzitet me qeverisjen që ka, ai ka të drejtën e amendamentimit të kushtetutës, apo të drejtën në revolucion për të përmbysur rendin ekzistues në tërësi, ose vetëm qeverinë ekzistuese".[22]

Strukturën e brendshme të federatës mund ta klasifikojmë edhe sipas kriterit të ndërlikueshmërisë së saj. Mbi bazën e këtij kriteri kemi **federatat e përbërjes së thjeshtë**, ku ekziston një lloj i njësisë federale i njëjtë me të gjitha njësitë tjera federale. Kjo nënkupton që njësitë federale janë faktor të barabartë dhe konstituiv të federatës si tërësi, që kanë të drejta e detyrime të njëjta. Te ky lloj i federatës nuk është e domosdoshme që njësitë federale të jenë institucionalisht dhe në aspektin juridiko-kushtetues krejtësisht të barabarta mes veti (të tilla nuk janë as në realitet) dhe mund të kenë numër të ndryshëm të përfaqësuesve në dhomën e sipërme të parlamentit federal. Në këtë

[21] Maurizio Ragazzi, "CONFERENCE ON YUGOSLAVIA ARBITRATION COMMISSION: OPINIONS ON QUESTIONS ARISING FROM THE DISSOLUTION OF YUGOSLAVIA "*International Legal Materials* Vol. 31, No. 6 (NOVEMBER 1992), fq. 1488-1526; Peter Radan, "The Badinter Arbitration Commission and the Partition of Yugoslavia". *Nationalities Papers* Vol. 25 No 3 (1997), fq. 537-557; Enver Hasani, "Self-Determination under the Terms of the 2002 Union Agreement between Serbia and Montenegro: Tracing the Origins of Kosovo's Self-Determination". *Chicago Kent Law Review* Vol. 80 No. 1 (December 2004), fq. 305-329; Malgosia Fitzmaurice, "Badinter Commission (for the Former Yugoslavia)". *Max Planck Encyclopedia of Public International Law* [MPEPIL] (June 2019) (Oxford University Press: Oxford, 2023).

[22] Cf. më shumë në Thomas J. Pressly, "Bullets and Ballots: Lincoln and the 'Right of Revolution'". *The American Historical Review* Vol. 67, No. 3 (April 1962), fq. 647-662; Gary J. Jacobsohn, "Abraham Lincoln 'On This Question of Judicial Authority': the Theory of Constitutional Aspiration". *Political Reseacrh Quarterly* Volume 36 Issue 1 (1983), fq. 52-70; Herman Belz, "Abraham Lincoln and American Constitutionalism". *The Review of Politics* Vol. 50 No. 2 (Spring, 1988), fq. 169-197; Herman Belz, "The 'Philosophical Cause' of 'Our Free Government and Consequent Prosperity': The Problem of Lincoln's Political Thought". *Journal of the Abraham Lincoln Association* Volume 10 No. 1 (1988), fq. 47-71.

grup numërohen federatat evropiane, si: **Austria**, **Gjermania** dhe **Zvicra**. Kjo e fundit, përveç kantoneve (20 sosh), ka edhe gjysmëkantonet (6 sosh), që kanë me përgjysmë më pak përfaqësues në dhomën federale të parlamentit, përkatësisht në Senatin zviceran ("Der Ständerat"), përkatësisht dy me një.[23] Ngjashëm me këtë, as në Gjermani të gjitha njësitë federale nuk kanë numër të njëjtë të përfaqësuesve në **Bundesrat**, dhomën e sipërme të parlamentit (nga tre në gjashtë), dhe as emërtime të njëjta. Berlini dhe Hamburgu janë qytet-shtete ("Stadtstaaten"), **Bremeni** është qytet i lirë hansaetik, kurse trembëdhjetë njësitë tjera federale janë vende ("Lander"). Edhe **Çekosllovakia** ka qenë e përbërjes së thjeshtë.

Lloj tjetër i federatës janë **federatat e përbërjes së përzier**, që kanë lloje të ndryshme të njësive federale, që krahas kësaj janë edhe me pozita të ndryshme në rendin kushtetues. Si të tilla, ky lloj i federatave është karakteristikë e shteteve jashtë Evropës, përfshirë këtu **Federatën e Rusisë**. Përbërja e përzier e federatave nënkupton se ato kanë njësi federale me pozita të pabarabarta kushtetuese, me shkallë të ndryshme të pavarësisë dhe kompetencave. Në këto federata gjithashtu ekzistojnë edhe njësi politike me pozitë atipike. Sipas pozitës së njësive federale, **SHBA-ja** futet në tipin e federatave me përbërje të thjeshtë. Nëse në këtë strukturë federale fusim distriktin e posaçëm të **Kolumbisë** (me kryeqytetin e **Uashingtonit**) dhe **Portorikon**, atëherë **SHBA-ja** bëhet federatë me përbërje të përzier (në te ekzistojnë edhe territoret apo kolonitë, pa status të përcaktuar kushtetues). Federatë me përbërje të përzier është **India,** me 29 shtete dhe 7 territore të Unionit, të cilat, definohen si njësi federale por nuk janë të tilla, sepse pushtetin ekzekutiv në to e ushtron qeveria federale. Në federatat me përbërje të përzier i fusim edhe shtetet në të cilat kryeqyteti ka status të posaçëm federal. Në **Brazil** ekzistojnë 26 njësi federale ("Unidades Federativas") dhe një distrikt federal ("Distrito Federal") me kryeqytetin Brazilia, i cili ka disa cilësi të njësisë federale dhe vetëqeverisjes lokale. Në Argjentinë, krahas 23 njësive federale – provincave ("Provincias"), ekziston edhe qyteti autonom **Buenos Aires** ("Ciudad Autonoma de Buenos Aires"), që është kryeqyteti i vendit. Në **Meksikë**, krahas 31 shteteve anëtare ekziston një distrikt i posaçëm federal që përfshinë kryeqytetin **Meksiko Siti**.

4.2. Statusi juridiko-kushtetues

Edhe pse njësitë federale kanë strukturë dhe organizim shtetëror, vetëm federata është shtet sovran dhe i pavarur. Në të ankorohet epërsia e rendit juridik dhe e kushtetutës federale, përkundër që njësitë federale mund të kenë kushtetutat e tyre. Epërsia e kushtetutës federale dhe e rendit juridik të bazuar në të, nënkupton që sovraniteti ankorohet në federatë dhe jo në njësitë federale. Ekziston edhe mendimi tjetër, që thotë se në federatë hasim sovranitetin e ndarë, mes federatës dhe njësive federale, kurse pjesën më të madhe të sovranitetit e mban federata.

Sipas kualitetit dhe ekzistimit ose jo të sovranitetit, dallohen federatat e krijuara me **devolucion** në raport me ato të krijuara me **agregacion**. Te federatat e krijuara me **devolucion**, sovraniteti bartet nga shteti unitar, i cili më pastaj e bartë atë pjesërisht në njësitë federale. Kjo nënkupton që burim i sovranitetit është federata, kurse njësitë federale kanë sovranitet të derivuar (prejardhur), që rrjedhë nga sovraniteti federal dhe atë në masën që është bartur në to me kushtetutën federale. Te federatat e krijuara me **agregacion**, bartja e sovranitetit shkon në drejtim të kundërt. Njësitë federale i kanë dhënë një pjesë të sovranitetit të saj federatës, duke mbajtur për vete një pjesë të tij. Kjo nënkupton se, me këtë rast, sovraniteti i njësive federale është më i vjetër se sovraniteti i federatës së krijuar rishtazi nga vetë ato, ose së paku e barabartë nga mosha nëse ka ekzistuar një federatë së cilës njësia federale iu është bashkangjitur. Nga kjo logjikisht rrjedh se cilësia e sovranitetit që federata e ka fituar nga shteti unitar më i madh sesa në rastet kur sovraniteti në federatë bartet nga njësitë federale. Realiteti tregon, megjithatë, se gjërat qëndrojnë ndryshe – sovraniteti i bartur nga njësitë federale në

[23] Në kuptimin literal, **Der Ständerat** ka kuptimin e Këshillit të Shtetit, dhe është dhoma e lartë e Kuvendit Federal të Zvicrës. Si dhomë e ulët është Këshilli Nacional ("Nationalrat"). **Der Ständerat** ka 46 anëtarë, kurse **Nationalrat** ka 200 anëtarë.

federatë është e përhershme dhe, për rrjedhojë, më kualitative dhe më përmbajtësor, më pak e kontestueshme dhe i nënshtrohet rishikimit. Si arsye për këtë mund të jetë fakti që bartja e sovranitetit dhe krijimi i federatës me devolucion paraqet shtetndërtim përmes ndërtimit gradual të shtetit (sepse ngelet më pak pushtet shtetëror, pas bartjes), kurse agregacioni është proces i ndërtimit të shtetit si një bashkësi e re politike ose mbindërtimi dhe fuqizimi i shtetit ekzistues.

Për pozitën juridiko-kushtetuese të federatës ka rëndësi të madhe marrëdhënia juridiko-kushtetuese mes njësive shtetërore brenda saj. Në njërën anë ekziston marrëdhënia mes federatës dhe njësive federale, që konsiston, në rend të parë, në ndarjen e jurdiksionit dhe kompetencës. Marrëdhënia tjetër nuk është e rëndësisë primare për statusin juridiko-kushtetues të federatës dhe ka të bëj me marrëdhënien reciproke mes njësive federale.

4.2.1. Kushtetuta federale

Për dallim nga sistemi juridik në shtetin unitar, kushtetuta e federatës ka konkurrent sepse ekziston pluralitet i rendeve juridike. Kjo, megjithatë, nuk nënkupton që kushtetuta federale nuk është akti më i lartë në shtet dhe as që njësitë federale janë shtete të vërteta, sovrane dhe të pavarura, sepse kanë kushtetutë. Pluraliteti i kushtetutave në federatë flet për strukturën e përbërë (të ndërlikuar) të federatës. Pa një akt suprem juridik, më i lartë se çdo akt tjetër juridik në nivel shteti, nuk do të ishte i mundur ndërtimi i sistemit juridik unik, dhe as që do të mund të ruhej integriteti juridik i shtetit të përbërë.

Secila kushtetutë normon organizimin e pushtetit, origjinën dhe mënyrën e funksionimit të tij. Këtë e bën edhe kushtetuta federale, përmes krijimit të organeve të pushtetit. Përveç që rregullon pushtetin ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor si dhe të gjyqësisë kushtetuese, kushtetuta federale bën edhe definimin dhe shpërndarjen e kompetencave mes federatës dhe njësive federale, rregullon kompetencat e niveleve më të larta të pushtetit, të regjioneve (nëse ekzistojnë), në ndërkohë që pozitën e vetëqeverisjes lokale e rregullojnë, sipas rregullit, njësitë federale. Organizimi i pushtetit që bëhet me kushtetutën e njësisë federale ka të bëj me organet ligjvënëse, ekzekutive dhe gjyqësore të njësisë federale, si dhe me gjykatën kushtetuese (kur ekziston një e tillë). Si pjesë e kushtetutës së njësisë federale mund të jetë edhe rregullimi i organizimit vertikal të pushtetit, nëse normohet pozita e regjioneve dhe vetëqeverisjes lokale në territorin e saj, gjithnjë me supozim që një materie e tillë nuk është rregulluar me kushtetutën federale.

Kur në federatë ekzistojnë "më shumë akte juridike supreme", thënë kushtimisht, atëherë fuqia sipërore juridike e kushtetutës federale ndiqet nga epërsia absolute e ligjeve federale kundrejt ligjeve të njësive federale. Kjo është kështu për shkak se ligjet e njësive federale duhet të jenë në pajtim me kushtetutën dhe ligjet federale. Në mënyrë që një sistem i tillë të jetë funksional dhe të mundësoj sundimin e së drejtës, atëherë me kushtetutën federale rregullohet roli dhe pozita e organeve të pushtetit kurse kompetencat e njësive federale nuk mund të ndryshohen me kushtetutat e njësive federale, sikundër që as materia e caktuar nuk mund të rregullohet ndryshe me ligjet dhe aktet e njesive federale nga rregullimi i përcaktuar me kushtetutë dhe ligjet federale.

Në mënyrë që kushtetuta federale në praktikë të ruaj dhe realizoj supremacinë e saj kundrejt çdo akti tjetër juridik në shtet, atëherë duhet të ekzistoj një organ i mbrojtjes së saj, në një sistem të ndërlikuar siç është sistemi federal i së drejtës. Ai organ që mbron supremacinë e kushtetutës federale ka kompetencë për të eliminuar nga rendi juridik çdo akt të përgjithshëm më të ulët juridik që bie ndesh me kushtetutën federale, duke i shpallur si jokushtetues, përfshirë këtu aktin juridik më të lartë të njësisë federale-kushtetutën e njësisë federale. Ky organ në federatat evropiane quhet **gjykatë kushtetuese**, kurse në të tjerat, në federatat jashtë **Evropës**, si në **Argjentinë**, **Brazil**, **Indi**, **Kanada**, **Meksikë**, **SHBA**, ai organ quhet gjykatë supreme (ose tribunal

suprem). Në këto federata, gjykata supreme është pjesë e gjyqësorit të rregullt, kurse mbrojtjen e kushtetutshmërisë e realizojnë edhe gjykatat tjera të rregullta, pra jo vetëm gjykata supreme. Kjo nuk është kështu në vendet ku ekziston një gjykatë kushtetuese, e ndarë nga gjyqësori i rregullt, e cila ka monopol të vetëm për mbrojtjen e kushtetutshmërisë përmes rrugës juridiksionale. Edhe në sistemin evropian, megjithatë, ka raste kur ekziston një gjykatë e ndarë kushtetuese, por në të njëjtën kohë edhe gjykatat e rregullta kanë kompetencë për kontrollin e kushtetutshmërisë gjatë gjykimit të rasteve dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të paraqitura pranë tyre. I tillë është rasti, ta zëmë, me **Tribunalin Kushtetues të Portugalisë**, i cili kultivon sistemin e përzier të gjyqësisë kushtetuese. U mor vesh, ky vend nuk është federatë dhe federalizmi nuk ka lidhje të domosdoshme me pasjen ose jo të gjyqësisë së ndarë kushtetuese, me një gjykatë kushtetuese të veçantë (sistemi evropian ose kelsenian i gjyqësisë kushtetuese). Historikisht shikuar, megjithatë, ka qenë federata si formë e shtetit ajo që ka luajtur një rol të konsiderueshëm në ndërtimin e nevojës për pasjen e mekanizimit të kontrollit kushtetues me qëllim të sigurimit të epërsisë së kushtetutës federale. E kemi fjalën për rastin historik që ka vënë themelet e sigurimit gjyqësor të epërsisë së ligjit më të lartë ne vend, kushtetutës, kundrejt ligjeve të tjera-rasti **Marbury v. Madison** (1803) i **Gjykatës Supreme të SHBA** (GJSAm).[24]

Kushtetuta federale nuk duhet të konsiderohet si akti më i lartë juridik i imponuar njësive federale dhe as si një dokument që pengon ndërtimin e organizimit të pushtetit në njësi federale dhe të sistemit të tyre juridik. Është e vërtetë që pushteti kushtetutëbërës gjendet në duart e federatës, por në procesin e kushtetutëbërjes marrin pjesë edhe njësitë federale. Rregullat mbi procedurën e kushtetutëbërjes gjenden në vetë kushtetutën federale. Zakonisht është parlamenti dydhomësh ai që miraton (sjell) kushtetutën dhe atë me shumicë të posaçme, të kualifikuar (dy të tretat, tri të katërtat, tri të pestat). Këtu kërkohet pëlqimi i dy dhomave të parlamentit, me çka mbrohen interesat e njësive federale, të cilat kanë përfaqësuesit e tyre në dhomën e sipërme të parlamentit. Përveç kësaj pjesëmarrjeje të tërthortë në procesin kushtetutëbërës, vetë njësitë federale mund të marrin pjesë drejtpërdrejtë në këtë proces, me fillim nga e drejta për propozimin e kushtetutës së re federale e deri të vendosja e drejtpërdrejtë për miratimin e tyre. I tillë është rasti me SHBA-në. Gjithashtu, nëse procedura federale e kushtetutëbërëjes përfshinë edhe referendumin, atëherë njësitë federale përmes "qytetarëve të tyre" marrin pjesë në miratimin dhe amendamentimin e kushtetutës federale. Me vetë faktin që njësite federale marrin pjesë në miratimin dhe amendamentimin e kushtetutës federale, ato në të vërtetë japin pëlqimin e tyre për të gjitha dispozitat kushtetuese. Edhe atëherë kur përfaqësuesit e njësisë federale nuk votojnë për kushtetutën e re, kurse ajo miratohet më një shumicë të caktuar, e njëjta ka fuqi të detyrueshme juridike edhe për to. Mosvotimi i njësisë federale për kushtetutën federale nuk përjashton të drejtën e tyre për organizim dhe pjesëmarrjen në organet federale të pushtetit, njëjtë sikur të kishte votuar për kushtetutë. Përkundër që nuk ka pasoja juridiko-kushtetuese, një gjë e tillë ka pasoja politike, siç është, ta zëmë, prishja dhe përkeqësimi i marrëdhënieve mes njësisë federale dhe federatës.

[24] Për rolin e federalizmit në krijimin dhe zhvillimin e gjyqësisë kushtetuese, si në aspektin teorik ashtu edhe atë praktik, përfshirë këtu pikëpamjet e **Hans Kelsen** (Hans Kelsen: 1881-1973), doajenit të modelit evropian të gjyqësisë kushtetuese, cf. më shumë në Sara Lagi, "Hans Kelsen and the Austrian Constitutional Court (1918-1929)" *Revista Co-herencia* Vol. 9 No 16 (Enero - Junio 2012), fq. 273-295; Enver Hasani & Muhamet Brahimi, *Gjyqësia kushtetuese*, kapitujt 2 dhe 3 (fq. 33-81); Stephan G. Hinghofer-Szalkay, "The Austrian Constitutional Court: Kelsen's Creation and Federalism's Contribution?" *Fédéralisme* 2034-6298 Volume 17: 2017 *Les juridictions constitutionnelles suprêmes dans les États fédéraux: créatures et créateurs de fédéralisme*, 1671. Në internet: https:// popups.uliege.be/1374-3864/index.php?id=1671 (shikuar më 7 prill 2023); Tamara Ehs, "Felix Frankfurter, Hans Kelsen, and the Practice of Judicial Review" *Zeitschrift für ausländisches öfentliches Recht und Völkerrecht, ZAORV = Heidelberg Journal of International Law*, HJIL, Vol. 73 No. 3 (2013), fq. 451-481 në fq. 463-465; Enver Hasani, "Judicial Review of Democracy. Maintenance of Democracy as a Functionalist Mission in the Jurisprudence of the Constitutional Court of Kosovo" *Südosteuropa* Vol. 68 No. 4 (2020), fq. 530–553; Reinin, Ewald, "From the Federalist Papers to Hans Kelsen's "Dearest Child": The Genesis of the Austrian Constitutional Court", *Zeitschrift für öffentliches Recht/Journal of Public Law* Vol. 76 Issue 2 (June 2021), fq. 313-329.

4.2.2. Sistemi juridik në federatë

Sistemi juridik në federatë është më i ndërlikuar se sistemi juridik në një shtet unitar, me vet faktin që në të ekzistojnë më shumë kushtetutëbërës dhe ligjvënës, në nivel të federatës dhe të njësive federale. Në shtetin unitar ekziston vetëm një ligjvënës dhe një kushtetutëbërës (lidhur me pushtetin ligjvënës, ekzistojnë përjashtime në shtete unitare që kanë një decentralizim të lartë). Për këtë arsye në federatë më vështirë është të arrihet harmonia e sistemit juridik edhe harmonizimi i akteve të ndryshme juridike. Sistem unik juridik është ai që përfaqëson tërësinë, një rend i rrumbullakuar i akteve juridike brenda shtetit. Në federatë njihen më shumë tërësi të tilla. Njëri është sistemi juridik i federatës, në të cilin, si rrethi më i madh me strukturë normative, hyjnë sistemet juridike të njësive federale, kurse brenda rretheve të tilla më të vogla janë rendet juridike të vetëqeverisjes lokale. Detyra e normave juridike që sjell federata është që përmes tyre të rregullohen në mënyrë unike çështjet që janë me rëndësi për shtetin si tërësi dhe krejt qytetarët e tij. Me kushtetutë federale, në këtë kuptim, rregullohet parimet themelore të rendit juridik-kushtetues: sundimi i së drejtës, sovraniteti popullor, rregullimi demokratik, liria e veprimit politik, si dhe liritë dhe të drejtat e të gjithë qytetarëve. Uniteti i sistemit juridik në këto çështje nënkupton që sundimi i së drejtës dhe rregullimi demokratik janë themele të ndërtimit të sistemit juridik federal dhe nëpër njësi federale dhe bashkësi të tjera politike joqendrore, kurse liritë dhe të drejtat e njeriut të garantuara me kushtetutën federale vlejnë në nivel federal dhe në secilin nivel joqendror të bashkësive politike.

Në rastin konkret lidhur me organizimin e pushtetit, uniteti i sistemit juridik dhe realizimi i parimeve të rendit juridik – kushtetues nënkupton që parimi i bartjes së sovranitetit të qytetarëve në trupin përfaqësues përkthehet ashtu që parlamenti federal dhe parlamentet e njësive federale zgjidhen nga ana e qytetarëve. Kur bëhet fjalë për liritë dhe të drejtat e qytetarëve, uniteti i sistemit juridik nënkupton që qytetarët në kushte të barabarta realizojnë të drejtat zgjedhore. Paraprakisht përcaktohet që njësitë federale nuk guxojnë të përcaktojnë kushte më të rrepta për fitimin dhe realizimin e të drejtave zgjedhore, ta zëmë kërkesa për më shumë vite (moshë), sesa ato të vëna në kushtetutën federale. Sa i përket të drejtës për shtetësi, sistemi unik juridik shprehet në prodhimin e dokumenteve të njëjta personale, të cilat i posedojnë qytetarët, që dëshmojnë përkatësinë ndaj federatës, siç është rasti me **pasaportat**, si dhe në regjimin e njëjtë të së drejtës për shtetësi. Përjashtimisht, në shtetet federale mund të ekzistojnë **e drejta për shtetësi të dyfishtë** (që i ofron me konfederatat), ku qytetarët kanë shtetësinë e njësisë federale dhe të federatës, në të njëjtën kohë. Kështu ka qenë në **Jugosllavinë komuniste.** Ky regjim i shtetësisë ka prodhuar pasoja vetëm në planin e brendshëm, në ndërkohë që sistemi juridik nga jashtë është parë dhe dukur si një dhe unik, i vetëm, që është përfaqësuar më një shtetësi dhe një shtet – me federatën.

Në çdo shtet, sistemi juridik duhet të jetë i harmonizuar sipas **parimit të hierarkisë**. Kjo nënkupton që përmbajtja e akteve më të ulëta juridike duhet të jetë në përputhje me përmbajtjen përkatëse të akteve më të larta juridike, me fillim nga aktet nënligjore deri te kushtetuta. Krahas kësaj duhet të ekzistoj edhe pajtueshmëria formale e dispozitave, që nënkupton se akti juridik prodhohet nga organi kompetent, sipas një procedure të paracaktuar dhe të ketë formën përkatëse. Nisur nga fakti se në federatë në disa vende prodhohen dispozitat juridike, veçanërisht ligjet e njësive federale, për realizimin dhe ruajtjen e harmonisë së rendit juridik si parim (në praktikë është e pamundur të arrihet ky ideal), atëherë duhet të ekzistoj një pushtet i pavarur që në mënyrë objektive dhe profesionale mbron pozicionin e hierarkisë supreme të kushtetutës federale si dhe të vendin e ligjeve dhe akteve të tjera federale kundrejt ligjeve dhe akteve të tjera të njësive federale. Një pushtet i tillë është i domosdoshëm në federatë dhe përfaqësohet nga gjykata kushtetuese ose gjykata supreme.

Rendi juridiko-kushtetues është në veçanti fleksibël në federatat me përbërje të përzier, ku ekzistojnë njësi federale me statuse të ndryshme, kompetenca dhe organizim pushteti (India, Federata Ruse etj). Në këto raste, me dispozita juridike federale, kushtetutë e ligje, i lihet më shumë hapësirë njësive

federale që në mënyrë të ndryshme të normojnë çështjet siç janë: kompetenca e organeve të njësive federale ose të drejtat dhe detyrimet konkrete të gjyqtarëve. Vetë rregullimi asimetrik nuk mund të jetë në kundërshtim me atë që është normuar me dispozita federale dhe as nuk bën që me akte juridike të dilet prej kufijve të përcaktuar me dispozita federale. Me kushtet të tilla të definuara në këtë mënyrë, sistemi juridik do të ngelet unik, por më shumë i strukturuar dhe me më shumë detaje. Kështu, ta zëmë, asimetria ekziston nëse në një grup të njësive federale zgjedhjet parlamentare zhvillohen çdo katër vjet kurse në tjerat në çdo pesë vjet, në ndërkohë që në kushtetutën federale kjo çështje nuk është e normuar **stricto sensu**.

4.2.3. Subjektiviteti shtetëror-juridik dhe sovraniteti i federatës

Në aspekt të statusit juridik, vetëm federata është person juridik, me kuptim që ka statusin e personit juridik në të drejtën e brendshme. Federata mund të jetë bartëse e të drejtave dhe detyrimeve, të cilat rrjedhin, ta zëmë, nga e drejta e pronësisë, mund të jetë palë në procedura gjyqësore dhe procedura të tjera juridike, paditëse dhe e paditur, të merr pjesë në qarkullimin juridik në përgjithësi. Federata është person juridik në të drejtën ndërkombëtare. Ajo është, jo njësitë federale, subjekt i së drejtës ndërkombëtare dhe ndërton marrëdhëniet ndërkombëtare. Ajo lidhë dhe zgjidhë marrëveshjet ndërkombëtare, fiton anëtarësim në organizata ndërkombëtare, realizon bashkëpunimin politik, ekonomik, ushtarak dhe tjetër me shtetet e huaja. Në këtë kontekst, qeveria federale posedon resorin për punë të jashtme, përmes të cilit realizon aktivitetet ndërkombëtare. Organet e federatës, qeveria ose shefi i shtetit, përfaqësojnë dhe prezantojnë shtetin në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Njësitë federale kanë statusin e personit juridik në të drejtën e brendshme, por mund të posedojnë edhe cilësi të caktuara të pjesshme juridiko-ndërkombëtare. Subjektiviteti i tyre në të drejtën ndërkombëtare është i kufizuar dhe ka të bëj me fushat e caktuara, siç janë ekonomia dhe kultura dhe bashkëpunimi me njësitë federale ose regjionet e shteteve të tjera, anëtarësimin në disa organizata ndërkombëtare të karakterit joshtetërore ose hibrid (ta zëmë, anëtarësimi në **UEFA**). Marrë parasysh këtë **paralelizëm të aktiviteteve të federatës dhe njësive federale në sferën e marrëdhënieve ndërkombëtare**, duhet në parim të përcaktohet vija ndarëse e kompetencës mes tyre. Federata negocion, lidh marrëveshje ndërkombëtare dhe hyn në marrëdhënie me shtetet tjera dhe organizatat ndërkombëtare kur bëhet fjalë për çështjet shtetërore, siç janë futja në një aleancë ushtarake ose themelimi i marrëdhënieve diplomatike, thënë shkurt federata udhëheq me politikën e jashtme shtetërore. Njësitë federale ndërtojnë marrëdhëniet ndërkombëtare me subjektet tjera në çështjet që nuk janë të interesit shtetëror dhe as që iu takojnë krejt qytetarëve të shtetit. Në mënyrë që të ekzistoj një harmoni në këtë veprim në marrëdhëniet ndërkombëtare të federatës dhe njësive të saj, këto të fundit janë të detyruara t'i përshtatin aktivitetet e tyre me politikën e jashtme të federatës. Kjo nënkupton që, nëse federata nuk ka marrëdhënie diplomatike me një shtet, as **njësitë federale** nuk mund të bashkëpunojnë me bashkësitë e caktuara politike brenda atij shteti. Kjo do të thotë që **njësia federale nuk mund të rrënoj politikën e jashtme të federatës** dhe, rrjedhimisht, **as integritetin dhe sovranitetin e jashtëm**, por as të ndërtoj marrëdhënie ndërkombëtare që kanë natyrë parashtetërore të karakterit politiko-juridik. Nga kjo del qartë se hapësira e veprimit të tyre është e ngushtuar dhe kufizohen në fusha jopolitike, siç janë **ekonomia**, **kultura**, **arsimi**, **sporti**.

Sa më shumë e lirë dhe më asimetrike të jetë federata në raport me njësitë e saj federale, me premisa që ngjasojnë shumë në konfederatë, aq më shumë pavarësi do të kenë njësitë federale në sferën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Rast tipik i kësaj është **Bosnjë-Hercegovina**, në të cilën entitetet kanë të drejtën e lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare me shtete tjera dhe me organizatat ndërkombëtare, me pëlqimin paraprak të **Kuvendit Parlamentar** të Bosnjë-Hercegovinës, në ndërkohë që për disa prej marrëveshjeve ndërkombëtare një pëlqim i tillë as që kërkohet. Në kategorinë e fundit hyjnë marrëveshjet mes **Republikës së Serbisë** dhe entitetit "Republika Sërpska", që është krijuar si rezultat i pastrimit etnik dhe gjenocidit kundër myslimanëve dhe kroatëve të **Bosnjë-Her-**

cegovinës, për themelimin e marrëdhënieve speciale mes tyre. Me këto lloje të marrëveshjeve për marrëdhënie speciale (e fundit është lidhur në vitin 2006), zhvillohen marrëdhëniet e posaçme mes Republikës së Serbisë dhe "Republika Sërpska" në sferat si: ekonomia, legjislacioni, shkenca, arsimi, kultura dhe në sferat tjera që bien në kompetencën e entitetit (Shteti i Bosnjë – Hercegovinës përbëhet prej dy entiteteve, Federata e Bosnjë-Hercegovinës dhe "Republika Sërpska"). Edhe entiteti tjetër, Federata Bosnjë-Hercegovinës, ka lidhur një marrëveshje të ngjashme me Kroacinë në vitin 1999.

Subjektiviteti juridiko-ndërkombëtar i njësive federale nuk guxon të rrezikoj sovranitetin e federatës, e cila është bartëse e sovranitetit, që manifestohet në pavarësinë e saj për udhëheqjen e marrëdhënieve me vendet (shtetet) tjera sovrane dhe të pavarura dhe me subjektet tjerë të së drejtës ndërkombëtare. Edhe elementi i brendshëm i sovranitetit, në pjesën më të madhe gjendet në duart e federatës, si për sa i përket monopolit të ushtrimit të dhunës fizike ashtu edhe lidhur me epërsinë e të drejtës federale. Organet që kanë monopol në ushtrimin e dhunës fizike mund të jenë federale dhe të njësive federale, siç është rasti me policinë, por mbrojtja (ushtria) çdoherë është federale. E drejta e federatës ka epërsi kundrejt të drejtave të njësive federale kur ato normojnë të njëjtat çështje juridike. Ekzistojnë çështje, megjithatë, të cilat bien vetëm në sferën rregullative të njësive federale apo vetëm në sferën rregullative të nivel federal. Nga kjo rrjedh që **sovraniteti i brendshëm** është i ndarë, ashtu që njësitë federale në kuadër të pavarësisë së tyre gëzojnë një pjesë të sovranitetit. Çka konsiderohet ushtrim sovran i pushtetit e çka një çështje që normohet nga njësia federale, një gjë e tillë përcaktohet me vetë kushtetutën federale. Kjo kushtetutë përcakton kompetencën e njësive federale, që do të thotë se njësitë federale pushtetin e tyre dhe sovranitetin e bazojnë në kushtetutën federale dhe, si të tilla, nuk janë bartëse të pushtetit **konstitutiv origjiner**. Rastet ku ato posedojnë një pushtet të tillë, janë të rralla, dhe përcaktohen me kushtetutën federale. Kjo çështje përbën esencën e debatit lidhur me federalizmin, krijimin dhe likuidimin e tij në situatat konkrete historike. I tillë ka qenë edhe debati brenda ish-Jugosllavisë në vitet e fundit të jetës së saj: serbët në vazhdimësi kanë pohuar se e drejta për shkëputje u takonte popujve, jo republikave federale, të cilat ishin njësi federale me të drejtat e detyrime të barabarta. Këtë argument serbët e mbështesnin në të drejtën e pashtershme të popujve për ushtrim të pushtetit konstitutiv, diçka që nuk përcaktohej me **Kushtetutën RSFJ-së 1974**, e cila atëherë ishte në fuqi. Kjo kushtetutë nuk përcaktonte as të drejtën për vetëvendosje të jashtme të njësive federale, sepse përcaktonte se ish-Jugosllavia ishte krijuar si rezultat i ushtrimit të kësaj të drejte nga popujt jugosllav (minus shqiptarët, hungarezët dhe jugosllavët tjerë, të cilat trajtoheshin si minoritete apo kombësi). Këtë dilemë tipike federaliste, që nuk e kishte zgjidhur **Kushtetuta e RSFJ-së 1974**, e zgjodhi **Komisioni Badinter**, i cili tha se vetëm ish-republikat federale të ish-Jugosllavisë kishin të drejtën e pavarësisë së plotë, **të drejtën e vetëvendosjes së jashtme**, kurse krahinat autonome dhe popujt tjerë që kishin ngelë brenda këtyre republikave federale që u bën shtete sovrane dhe të pavarura, kishin vetëm **të drejtën e vetëvendosjes së brendshme**, pra vetëm të drejtën për autonomi, sundim të ligjit, demokraci dhe respektim të të drejtave të tyre individuale dhe kolektive, si prestarë të kombeve të dikurshme që kishin formuar ish-**Jugosllavinë** si shtet komunist pas **Luftës së Dytë Botërore** (1943-1992).[25]

Kur vjen deri te përputhja apo shkelja e sovranitetit, si dhe deri te konflikti për kompetencë mes federatës dhe njësisë federale, atëherë fjalën e fundit e ka organi shtetëror që mbron dhe interpreton kushtetutën federale-**gjykata kushtetuese federale** ose **gjykata supreme që ushtron edhe funksionin e vlerësimit të kushtetutshmërisë** në shkallë të fundit. Me interpretimin e dispozitave të kushtetutës federale mbi përcaktimin e juridiksionit dhe kompetencës, ky organ konstaton se kush ka kompetencë në rastin apo mosmarrëveshjen konkrete, përkatësisht se pushteti i kujt është sovran për zgjedhjen e një çështjeje ose marrëveshjeje konkrete.

[25] Cf. më shumë edhe këto burime të shkëlqyera: Daniel Bethlehem, *The "Yugoslav" crisis in international Law: General issues* (Cambridge University Press: Cambridge, 1997); Ana S. Trbovich, *A Legal Geography of Yugoslavia's Disintegration* (Oxford University Oress: Oxford, 2008).

4.2.4. Ndarja e kompetencave në federatë

Njëra ndër çështjet më të rëndësishme në federatë, nëse jo më e rëndësishmja, është ndarja e kompetencës mes njësive federale dhe vetë federatës si shtet me subjektivitet të plotë jurdiko-ndërkombëtar. Përcaktimi i kompetencës flet për karakterin e rregullimit shtetëror të federatës – a është pjesë kryesore e pushtetit në federatë apo pushteti më shumë ushtrohet në nivel të njësive federale. Ndarja vertikale e pushtetit nuk përfundon në njësi federale, por lëshohet teposhtë, deri në nivel të vetëqeverisjen lokale, kurse përcaktimi i kompetencave me kushtetutë bëhet vetëm sa i përket federatës dhe njësive federale, vetëm sa i përket materies së punëve dhe çështjeve shtetërore. Kjo **ndarje e kompetencës mes shtetit dhe njësisë federale** nuk është e natyrës së ngurtë, por e natyrës së atillë që përcakton dhe rrumbullakon tërësitë shtetërore, të cilat në mënyrë të pavarur kryejnë punët e tyre respektive. Edhe atëherë kur kompetenca përcaktohet në mënyrë të detajuar dhe të thellë, duke i numëruar ato që i takojnë shtetit dhe të tjerat njësive federale, prapëseprapë ekziston ndërvarshmëria, përzierja dhe lidhshmëria reciproke në shumë fusha, siç janë: arsimi, urbanizmi, ekonomia ujore dhe të tjerat fusha.

Dy nivelet e pushtetit kanë **kompetencë origjinale**, të cilat përcaktohen me kushtetutën federale. Me këtë federata dallon nga unioni dhe konfederata, në të cilat shtetet sovrane dhe të pavarura besojnë kryerjen e disa punëve në nivel të lidhjes shtetërore, e cila, në rastin e unioneve dhe konfederatave, nuk ka asnjë **kompetencë origjinale** dhe as nuk ka organizim të përpunuar të pushtetit. E thënë me fjalë të tjera, unionet dhe konfederatat, si lidhje shtetërore shtetesh sovrane dhe të pavarura, kanë kompetencë të bartur dhe jo origjinale, nuk posedojnë pushtet të organizuar për të përballuar një kompetencë të përhershme. Kompetenca burimore e federatës vlen për të gjitha degët e pushtetit. Si kompetencë burimore e federatës është, në rend të parë, **ligjvënia**, kompetencë kjo që vlen për krejt territorin shtetëror. Këtu bëhet fjalë për **ligjet federale** që janë **ligje kuadër** ose **ligje mbi parimet bazë**, nga shkaku se në nivel parimi rregullojnë ndonjë fushë apo pozitën e ndonjë institucioni federal. Pushteti **ekzekutiv federal** udhëheqë politikën e jashtme dhe të brendshme të shtetit dhe ekzekuton ligjet federale. Pozita e ekzekutivit federal normohet me kushtetutën federale. Për dallim nga parlamenti federal, ekzekutivi federal nuk është përfaqësues, përkatësisht organ reprezentativ i njësive federale, por një organ i pastër federal, me përjashtim të rasteve të posaçme.

Gjykatat federale, ose gjykata, kur ekziston vetëm një, zgjidhin kontestet që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjeve federale. Në disa raste, organi më i lartë i pushtetit gjyqësor, gjykata supreme federale, gjykon në shkallë të fundit dhe zgjidhë kontestet lidhur me kushtetutshmërinë e ligjeve të njësive federale, siç janë, ta zëmë, **GJSAm**, **Gjykata Supreme e Kanadasë** (GJSKa) etj. Pushteti i drejtësisë kushtetuese detyrimisht ekziston në nivel federal dhe mund të ekzistoj edhe në nivel të njësive federale. Marrë parasysh faktin që ndarja e juridiksionit dhe kompetencave në shtetin federal është mjaft e ndërlikuar dhe se ekzistojnë shumë ligje të niveleve të ndryshme, ligjet federale dhe ligjet në nivel të njësive federale, është e domosdoshme që të ekzistoj organi që kontrollon kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë në nivel shteti. Pikërisht ekzistimi i **kontrollit kushtetues** dhe **kontrollit të ligjshmërisë** përbën një kusht të domosdoshëm për ekzistimin e federatës si shtet me një sistem unik juridik, në të cilin ekziston një ndarje e qartë e juridiksionit dhe kompetencës mes nivelit qendror federal dhe nivelit tjetër–atë të njësive federale. Nuk mjafton, pra, që të ketë një grumbull dispozitash të përgjithshme juridike, që përbëjnë sistemin federal dhe sistemin e njësive federale. Ato tërësi duhet të jenë në harmoni dhe duhet të ekzistoj një organ që kujdeset që ato të jenë në harmoni me njëra tjetrën, sipas sistemit piramidal, ku dispozitat më të ulëta i nënshtrohen atyre më të larta deri në normën kushtetuese.

Te ndarja e juridiksionit dhe kompetencës mes federatës dhe njësive federale dallohen **tri grupe**:

- një, juridiksioni dhe kompetencat që bien në domenin ekskluziv të federatës;
- dy, juridiksioni dhe kompetencat që bien në domenin ekskluziv të njësisë federale; dhe
- tre, juridiksioni dhe kompetencat që ndahen mes nivelit federal dhe njësitë federale.

Federata ka juridiksion dhe kompetencë ekskluzive për punët dhe çështjet që kanë të bëjnë me fushat që janë në interesin e të gjithë qytetarëve, që kanë interes dhe caqe shtetërore që përfshijnë krejt territorin dhe ata që gjenden në të. Këto punë dhe çështje nuk janë të përcaktuara në mënyrë të njëjtë në të gjitha federatat, mirëpo kryesisht kanë të bëjnë me fushat si vijon: mbrojtja e vendit, lufta dhe paqja, marrëdhëniet ndërkombëtare mes shteteve, valutën, doganat, njësitë matëse, telekomunikimet, shtetësinë dhe punë e çështjet tjera që janë në lidhje të ngushtë ose të tërthorët me sovranitetin.

Juridiksioni dhe kompetencat ekskluzive të njësive federale kanë të bëjnë me fushat që burojnë nga pavarësia e njësive federale dhe që nuk kanë rëndësi të drejtpërdrejtë nacionale, por janë në rend të parë në interes të qytetarëve të njësisë federale. Njësitë federale mund të realizojnë në mënyrë të pavarur juridiksionin dhe kompetencën e tyre ekskluzive në fushat siç janë: kultura, arsimi dhe shkenca, tregtia e brendshme, mbrojtja dhe siguria sociale, rregullimi i komunikacionit, punët e brendshme (policia) dhe fusha të tjera shoqërore.

Grupin e tretë dhe më të madh i quajmë **juridiksione dhe kompetenca paralele**. Këtu federata dhe njësia federale normojnë në mënyrë paralele marrëdhëniet dhe fushën e njëjtë shoqërore, por në atë mënyrë që ekziston dhe ruhet harmonia mes rregullimeve të tilla dhe kjo reflektohet në strukturat normative që prodhohen në dy nivelet. Kështu, federata miraton ligjet kuadër, ligjet parimore ose ligjet bazë, kurse njësia federale miraton ligje konkrete nga fusha dhe marrëdhënia e njëjtë shoqërore. Me ligj federal normohen bazat e një materie, parimet dhe rregullat themelore, kurse me ligjin e njësisë federale këto baza, parime dhe rregulla themelore përpunohen dhe konkretizohen më tutje. I tillë është rasti, ta zëmë, me ligjin federal për bazat e marrëdhënies së punës dhe ligjin e njësisë federale për marrëdhëniet e punës. Nëse federata nuk sjell ligjin nga një fushë dhe marrëdhënie shoqërore për të cilën ka të drejtë kushtetuese, atëherë një gjë të tillë mund ta bëj njësia federale dhe këtu kemi të bëjmë me juridiksion dhe kompetencë konkurrente. Ky ligj pushon të vlejë kur federata nxjerr ligjin e saj.

Juridiksioni dhe kompetenca e federatës dhe njësisë federale mund të ndahen edhe sipas kriterit të **juridiksionit dhe kompetencës së supozuar**. Si rregull, në federatë vlen supozimi i juridiksionit dhe kompetencës në dobi të njësive federale. Kjo është kështu dhe rrjedh si një pasojë logjike në federatat e krijuara me agregacion, përkatësisht në rastet kur nga shtetet ekzistuese krijohet federata, kurse vetë ato bëhen njësi federale duke humbur sovranitetin dhe pavarësinë e mëparshme. Juridiksioni dhe kompetencat e federatës përcaktohen me enumeracion, duke i përmendur një nga një në kushtetutë (numërimi taksativ i tyre), ashtu që krejt çka nuk përmendet shprehimisht në kushtetutën federale, i takon njësive federale. Kjo qasje ekziston në shumicën e federatave, gjë që potencialisht mund të jetë bazë për fuqizimin e tendencave dhe përpjekjeve centrifugale. Federata dobësohet sepse me zhvillimin shoqëror dhe ndërlikueshmërinë e marrëdhënieve shoqërore asaj i ngelet gjithnjë e më pak punë, kurse njësitë federale, duke normuar marrëdhëniet e re shoqërore forcohen edhe vetë. Në këtë mënyrë ka ndodhur zhvillimi kushtetues i **Jugosllavisë komuniste**, deri në shkatërrimin e saj përfundimtar në pranverë të vitit 1992. E njëjta mund të thuhet edhe për ish-**Bashkimin Sovjetik** dhe Çekosllovakinë, por edhe për **Indinë britanike**, që në fillim është përbërë nga India, Pakistani dhe Bangladeshi (1948-1971). Në të gjitha këto raste dhe në rastet e ngjashme ka ardhur deri te **triumfi i forcave centrifugale**. Origjina e fuqizimit të këtyre forcave mund të jetë nacionalizmi etnik, faktorët ekonomik, kulturor, gjuhësor dhe të tjerë, të cilët së bashko çojnë në krijimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve të tjera më kundërthënëse se ato të sanksionuara në kushtetutën federale. Në anën tjetër, janë shumë të rralla shtetet në të cilat vlen supozimi i juridiksionit dhe kompetencës në dobi të federatës. Kushtetuta federale dhe kushtetutat e njësive federale numërojnë taksativisht juridiksionin dhe kompetencat e njësive federale dhe organeve të tyre, krejt tjetër ngelet në duart e federatës. Me **Kushtetutën e Kanadasë**, e cila përfshinë aktet kushtetuese të vitit 1867 dhe 1982, në nenin 93 bëhet ndarja e juridiksionit dhe kompetencës ligjvënëse mes shtetit dhe provincave, përmes numërimit të fushave në të cilat, provincat si njësi federale, kanë juridiksion dhe kompetencë për të nxjerrë ligje. Në fakt, vetë nëntitulli i këtij neni është ”Materia ekskluzive për legjislacionin provincial”, kurse vetë neni mban titullin ”Pushtetet ekskluzive të legjislaturave provinciale”.

4.2.5. Organet e pushtetit në federatë

Për dallim nga shteti unitar, bashkësitë politike në federatë marrin pjesë në formimin e organeve të federatës. Kjo vlen për organin ligjvënës dhe atë për dhomën e tij të dytë. Njësitë federale përfaqësohen në **dhomën e lartë** të parlamentit federal. Përbërja e kësaj dhome përcaktohet në atë mënyrë që numri i përfaqësuesve të secilës njësi federale është i barabartë, kurse në rastet kur nuk është i barabartë, atëherë së paku një përfaqësues duhet të ketë secila njësi federale. Në dy këto modele mbrohet interesi i njësisë federale në procesin e ligjvënies dhe me rastin e marrjes së vendimeve të tjera nga juridiksioni dhe kompetenca e parlamentit federal. Përkundër kësaj, **parimi i shumicës** në vendimmarrje del më i rëndësishëm dhe më me peshë se sa interesi i secilës njësi federale, marrë parasysh se supozohet që parimi i shumicës mbron interesin e përgjithshëm. Ky parim, parimi i shumicës, është i domosdoshëm për funksionimin e federatës, e homogjenizon atë dhe i ndihmon të mbijetoj si shtet në të cilin ekzistojnë diversitete të shumta e të ndryshme.

Parimi i **përfaqësimit të barabartë** të njësive federale në **dhomën e sipërme** shpreh parimin e barazisë absolute të njësive federale, pa marrë parasysh numrin e popullsisë, territorin, fuqinë dhe zhvillimin ekonomik. Kjo nënkupton që njësia me numër më të madh dhe territor më të madh, fuqi dhe zhvillim më të madh ekonomik do të jetë e barabartë me përfaqësues me njësitë tjera që nuk kanë këto cilësi dhe, për pasojë, barazohen në marrjen e vendimeve në dhomën e sipërme të parlamentit federal. Kjo ka arsye dhe arsyetohet nëse njësitë federale shikohen si tërësi politike, të barabarta si njësi konstituive të shtetit federal, si krijues të këtij shteti. Si shembull tipik i kësaj shërben **Senati i Kongresit** të SHBA-së, i cili ka 100 senatorë, nga secili shtet nga dy sish. Ngjashëm vlen edhe për dhomën e sipërme të Parlamentit rus, **Këshilli i Federatës**, që ka 170 anëtarë, nga dy vetë prej secilës prej 85 njësive federale në **Federatën e Rusisë**, të cilët nuk janë anëtar të partive politike). Në disa federata të tjera, siç janë **Argjentina**, **Brazili** dhe **Meksiko**, të gjitha njësitë federale në dhomën e sipërme kanë nga tre përfaqësues, me disa modalitete.

Përfaqësimi jo i barabartë i njësive federale në dhomën e sipërme, në rend të parë synon të mbroj interesat e njësive federale që kanë më shumë banorë. Kjo quhet përfaqësim proporcional i njësive federale, përkundër faktit që ky proporcion në përfaqësim nuk mund të jetë i saktë asnjëherë dhe lëvizë ndërmjet numrit më të madh dhe më të vogël të përcaktuar me kushtetutë. Përvoja kushtetuese në këtë drejtim ndryshon. Në **Bundesrat**, dhomën e lartë të Parlamentit gjerman, **land**-et kanë më së paku tre e më së shumti gjashtë përfaqësues (nga gjithsej 69 sish), që nënkupton se dallimi më i madh është për tre përfaqësues, përkundër që land-i me më së shumti popullsi, **Rajna e Veriut-Vestaflia**, ka 27 herë më shumë popullsi krahasuar me njësinë më të vogël federale, **land**-in **Bremen**. Në **Austri** proporcioni është më i saktë, sepse kufiri i numrit të përfaqësuesve në dhomën e njësive federale lëviz nga 3 deri në 12 (nga gjithsej 61 sish). Një proporcion edhe më i saktë, shkaku i modifikimeve në përfaqësim në nivel regjional, haset në Senatin e **Kanadasë**, që numerikisht sillet nga 1 deri në 24 senatorë për secilën nga 13 provincat dhe territoret e vendit, të cilat janë të sistemuara në katër regjione gjithsej. Në Indi gjendja paraqitet pak më ndryshe, ku secila njësi federale duhet të ketë një përfaqësues në dhomën e lartë ("Rajya Sabha"), deri në 31 përfaqësues, të cilët i ka njësia federale me popullsi më të madhe **Uttar Pradesh**.

Mënyra e zgjedhjes për dhomën e lartë të parlamentit federal dallohet nga shteti në shtet, si dhe kohëzgjatja e mandatit. Zgjedhja mund të jetë e **drejtpërdrejtë**, nga ana e qytetarëve të njësisë federale. Ajo mund të jetë edhe **zgjedhje e tërthorët**, ku njësitë federale delegojnë përfaqësuesit e tyre Së fundi, zgjedhja mund të jetë edhe **zgjedhje e kombinuar** e përfaqësuesve të njësisë federale, ku krahas zgjedhjes së drejtpërdrejtë një numër senatorësh dominohen (caktohen) nga njësia federale. Në **SHBA** qytetarët drejtpërdrejt zgjedhin senatorët në njësitë e tyre federale, për gjashtë vite. Drejtpërdrejtë ata zgjedhën edhe në **Argjentinë** (për gjashtë vite), **Brazil** (për tetë vite), shumica prej tyre edhe në **Indi** dhe **Meksikë** (për gjashtë vite). Zgjedhja e tërthortë ekziston në **Gjermani**, ku i delegojnë qeveritë e njësive zgjedhore pas zgjedhjeve të tyre të drejtpërdrejta, në Austri zgjedhën nga ana e kuvendeve krahinore,

proporcionalisht me përbërjen e tyre, në pesë ose gjashtë vite. Në Rusi nga një përfaqësues e delegon pushteti legjislativ dhe ekzekutiv i njësisë federale (kuvendi dhe kryetari i njësisë federale). Në Kanada, senatorët i cakton guvernatori, me propozim të kryeministrit, me mandat të përjetshëm mirëpo më së largu qëndrojnë në detyrë deri në moshën 75-vjeçare. E lidhur ngushtë me zgjedhjen është edhe **natyra e mandatit të anëtarëve të dhomës së lartë** të parlamentit federal. Aty ku përfaqësuesit e njësive federale janë caktuar në mënyrë të tërthortë, ata kanë mandat të lidhur dhe mund të votojnë vetëm si delegacion (**en bloc**). Kjo nënkupton që gjashtë votat e **Bundesrat**-it gjerman nga krahina e Bavarisë do të jenë pro ose kundër një vendimi, pasur mundësi ndarjeje brenda delegacionit. Anëtarët e dhomës së lartë të zgjedhur drejtpërdrejtë, sipas rregullit gëzojnë mandat të lirë dhe votojnë sipas bindjes së tyre.

Sa i përket barazisë juridiko-kushtetuese me dhomën e ulët të parlamentit federal, dhoma e lartë ka më pak juridiksion dhe kompetencë. Nuk është i barazuar me dhomën e ulët në procedurën e ligjvënies, të drejtat e kësaj dhome kryesisht konsistojnë në të drejtën e vetos suspensive. Me vënien e kësaj vetoje, propozim-ligji kthehet në dhomën e ulët, e cila sjell vendimin përfundimtar ose harmonizohen dallimet mes dy dhomave. Dhoma e njësive federale ka të drejtën e iniciativës legjislative, të drejtën për thirrjen e seancave të parlamentit federal. Përjashtim nga kjo është **Senati i Kongresit** amerikan, i cili në aspektin juridiko-kushtetues në tërësi është i barabartë me Dhomën e Përfaqësuesve, kurse në realitet ka më shumë autoritet dhe fuqi.

Për dallim nga organi ligjvënës, në **pushtetin ekzekutiv të federatës**, që gjendet në duart e shefit të shtetit ose të qeverisë, **nuk ka përfaqësues** të njësive federale. Të rralla janë kushtetutat që përcaktojnë përfaqësim të njësive federale në qeverinë qendrore. I tillë ka qenë rasti me **Jugosllavinë komuniste**, ku **Kryesia e RSFJ-së** ka pasur tetë anëtarë, nga secila republikë dhe dy nga krahinat autonome të Kosovës dhe Vojvodinës. Ngjashëm ka qenë edhe rasti me ish-**Bashkimin Sovjetik**, ku **Presidiumi i BRSS-së** ka pasur pesëmbëdhjetë anëtarë, nga secila republikë federale nga një. Shumë të ngjashme me këto janë rregullat mbi formimin e qeverive në Belgjikë dhe Zvicër. Këshilli i Ministrave në **Belgjikë**, sipas nenit 99 të Kushtetutës së viti 1831, me amendamentet e vitit 2014, aktualisht në fuqi, më shumë se pesëmbëdhjetë anëtar; me përjashtim të kryeministrit, këshilli përbëhet nga një numër i barabartë i ministrave që flasin holandisht dhe atyre që flasin frëngjisht. Në Zvicër dikur ka ekzistuar një rregull, sipas së cilës në **Këshillin Federal**, që njëkohësisht është shef qeverie dhe shef shteti, kantonet kanë mund të përfaqësohen vetëm me nga një anëtar. Sot ai përbëhet nga shtatë anëtarë, sipas formulës që arrihet me marrëveshje partiake: dy plus, dy plus, dy plus dhe një (demokratë, demokristianë, socialdemokratë dhe një anëtar nga partia popullore), në ndërkohë që në nenin 175 (4) të **Kushtetutës së Zvicrës** (KZv) të vitit 1999, aktualisht në fuqi me amendamentet e fundit të vitit 2002, përcaktohet se duhet marrë parasysh përfaqësimi në mënyrë adekuate i regjioneve të ndryshme gjuhësore edhe gjeografike.

Si degë e pushtetit që formohet pavarësisht njësive federale, **ekzekutivi federal** është një levë e rëndësishme për mbajtjen dhe forcimin e integritetit dhe kohezivitetit politik dhe tjetër të federatës. Pjesë e qeverisë federale janë ministrat që udhëheqin resorët përkatës të organeve të administratës federale. Marrë parasysh faktin se ekziston prezumimi në favor të organeve të administratës nëpër njësi federale, organet federale të administratës kryejnë ato punë që janë me interes për shtetin si tërësi dhe për të gjithë qytetarët e tij (siç janë, ta zëmë, byroja për patente, markat dhe vulat tregtare etj). Dy sisteme të udhëheqjes me pushtetin, ai federal dhe sistemi i njësisë federale ekzistojnë si njësi organizative të ndara, pa marrëdhënie të mbivënies dhe nënvënies reciproke.

Organet e pushtetit gjyqësor ekzistojnë në nivel federal dhe në atë të njësive federale. Federata ka gjykatën më të lartë në shtet, gjykatën supreme ose gjykatën e kasacionit, por mund të ketë edhe gjykatat e specializuara që gjithashtu janë instanca e fundit gjyqësore në kontestet e juridiksionit dhe kompetencës së posaçme. Të tilla janë gjykatat administrative, gjykatat elektorale, gjykatat ushtarake, gjykatat ekonomike. Gjykatat federale gjykojnë në shkallë të fundit vetëm kur një gjë e tillë shprehi-

misht është paraparë me kushtetutë, kurse udhëheqin procedurat gjyqësore nga fillimi nëse kontesti është në juridiksion dhe kompetencë të jurisprudencës federale, ta zëmë lëndët gjyqësore lidhur me ushtrinë. Për dallim nga federata, pushteti gjyqësor në **njësitë federale** ka shumë shkallë, si në kontestet e juridiksionit dhe kompetencës së përgjithshme ashtu edhe në ato të juridiksionit dhe kompetencës së posaçme. Organizimi i **organit të akuzës** përcjell juridiksionin, kompetencën dhe hierarkinë e gjyqësorit, që nënkupton se ekziston organi federal i akuzës dhe organet disa shkallësh në nivel të njësisë federale.

Pushteti i **gjyqësisë kushtetuese** është i pashmangshëm në federata. Gjykata kushtetuese federale, ose gjykatat supreme me juridiksion dhe kompetencë për gjyqësi kushtetuese, është organ që garanton autoritetin përfundimtar të akteve dhe organeve të federatës. Ajo është diga kundër shndërrimit të formave shtetërore brenda federatës në shtete sovrane dhe të pavarura. Hierarkinë e akteve juridike të njësisë federale dhe autoritetin e kushtetutës së saj e mbrojnë gjykatat kushtetuese të njësive federale, të cilat, duhet thënë këtu, nuk ekzistojnë në të gjitha federatat. Në organet gjyqësore dhe në ato të gjyqësisë kushtetuese në nivel federal nuk ekziston "çelësi republikan", përkatësisht përfaqësimi i barabartë i njësive federale me rastin e zgjedhjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Një përfaqësim i tillë mund të merret parasysh në federatat me numër të vogël të popullsisë, kurse në federatat e mëdha territorialisht dhe në numër popullsie, një gjë e tillë është praktikisht e pamundur të realizohet. Këtu kemi parasysh shembullin e **Indisë**, **Rusisë**, **SHBA-së,** etj.

4.2.6. Statusi juridik-kushtetues i njësive federale

Federata aktualisht përfaqëson formën me të zhvilluar të decentralizimit, "megadecentralizim", që në të njëjtën kohë është edhe formë funksionale. Statusi i njësive federale nuk është i njëjtë në të gjitha federatat, nganjëherë dallojnë në status edhe brenda vetë shtetit të njëjtë. Disa karakteristika të statusit të tyre, megjithatë, mund të dallohen. Këto karakteristika të statusit të tyre juridiko-kushtetues diskutohen në vijim.

Në rend të parë, njësitë federale kanë të drejtën e **vetëorganizimit**. Kjo e drejtë garantohet me kushtetutë federale, si akti më i lartë juridik në vend. Sipas rregullit, federata normon disa çështje bazike të organizimit të pushtetit të njësisë federale: forma e qeverisjes, struktura e trupit ligjvënës, pozita e qeverisë. Njësia federale normon në mënyrë të pavarur të gjitha degët e pushtetit brenda kufijve të përcaktuar nga kushtetuta federale. Kjo nënkupton se ajo ka rendin e vet kushtetues, juridiksion dhe kompetenca burimore dhe një sistem të përmbyllur të ligjvënies, pushtetit ekzekutiv dhe gjyqësor që në mënyrë autonome i rregullon. Ndaj administratës, pushtetit administrativ të njësisë federale, federata nuk ka të drejtën e mbikëqyrjes, që flet për ekzistimin e autonomisë së plotë të njësisë federale në këtë fushë. E drejta e vetëorganizimit nënkupton që njësitë federale miratojnë aktin e tyre më të lartë me të cilin **rregullojnë organizimin e tyre të pushtetit**. Jo të gjitha njësitë federale kanë kushtetutat e tyre, siç është rasti, ta zëmë, në **Indi** (kjo konsiderohet si një mënyrë për të penguar shkëputjen e vendeve me shumicë myslimane), kurse aty ku ekzistojnë, ato kanë fuqi më të ulët juridike se kushtetuta federale. Për këtë arsye pushtetit kushtetutëbërës i njësive federale nuk është i pakufizuar dhe krejtësisht i lirë, për shkak se ekziston një kufi-respektimi apo moscenimi i dispozitave të kushtetutës federale me rastin e ushtrimit të pushtetit kushtetutëbërës. Ky kufizim zakonisht është i qartë në kushtetutën federale, e cila përcakton mënyrën dhe kufijtë e shprehjes së pushtetit kushtetutëbërës të njësive federale. Më këto dispozita ngushtohet hapësira për vetëorganizim të pushtetit në njësitë federale. Në nenin 193 të **Ligjit Themelor të Gjermanisë** (1949), **LTH**, kërkohet që njësitë federale të respektojnë dispozitat e tij dhe të ligjeve federale me rastin e ushtrimit të pushtetit kushtetutëbërës dhe pushtetit ligjvënës. Këto kufizime vlejnë edhe për çështjet tjera, siç janë ato lidhur me natyrën e rregullimit shtetëror të njësisë federale: në **KAm** njësitë federale duhet të kenë rregullim republikan shtetëror, jo monarkik. Mirëpo, ato vetëm mund të përcaktojnë emrin e shtetit të tyre, kështu që sot kemi "shtete" dhe katër "komonvelte" (Kentaki, Masaçusec, Pensilvani dhe Virxhinia). Në **Zvicër** kantonet gjithashtu mund të

kenë vetëm formën republikane të qeverisjes, kurse kushtetutat e tyre duhet të jenë në përputhshmëri me **KZv**.

Sa i përket çështjeve të statusit, përkatësisht të marrëdhënies juridiko-kushtetuese me federatën dhe njësitë tjera federale, ndërrimit të territorit, juridiksionit dhe kompetencës, heqjes dhe bashkimit të njësive federale, themelimit të njësive të tjera federale në territorin e njëjtë ose në territor të ri shtetëror, njësitë federale janë juridikisht të mbrojtura sepse kanë garancione kushtetuese për këtë. Në përgjithësi, statusi i tyre juridiko-kushtetues është i fortë dhe vështirë mund të ndryshohet. Për dallim nga format tjera të organizimit territorial, ndryshimi i statusit juridiko-kushtetues të njësive federale nuk mund të bëhet pa pëlqimin e tyre. Kjo në veçanti ka të bëj me pëlqimin në procesin e heqjes, bashkimit, ndarjes dhe krijimit të njësive të reja federale. Çështjet e statusit të njësive federale që janë të normuara me kushtetutë federale zakonisht mbrohen në atë mënyrë që vetë ato marrin pjesë në ndryshimin e kushtetutës federale. Kështu, ta zëmë, **KAm** kërkon pëlqimin e tri të katërtave të shteteve anëtare për ndryshimin e saj, kurse **Kushtetuta e Meksikës** e vitit 1917 me amendamentet e fundit të vitit 2015, aktualisht në fuqi, kërkon një shumicë absolute të krejt legjislaturave shtetërore për një gjë të tillë (propozimi për amendamentim, ndërkaq, bëhet me dy të tretat e votave të Kongresit federal). Kur bëhet fjalë për ndryshimin e juridiksionit, kompetencës dhe territorit të njësisë federale, atëherë për një gjë të tillë kërkohet pëlqimi shprehimor i vetë njësisë federale që është objekt i ndryshimeve në fjalë. Këtë pëlqim ajo e jep përmes parlamentit të vet ose përmes referendumit të qytetarëve të asaj njësie federale që afektohet me ndryshime të tilla.

5. Shtetet regjionale

5.1. Kuptimi dhe shembujt e shtetit regjional

Regjionale quhen shtetet që kanë formën e rregullimit shtetëror **mes federatës dhe shtetit unitar**: autonomia e regjioneve nuk është krejtësisht si te **njësitë federale** dhe as krejtësisht si te **kolektivitetet e decentralizuara**. Regjionet **nuk kanë kushtetutën** e tyre, për pasojë nuk kanë dhe nuk mund të ushtrojnë **pushtet konstituiv**, nga shkaku se nuk janë shtete por kolektivitete infra-shtetërore. Kjo cilësi kushtetuese i afron regjionet me kolektivitetet e decentralizuara, por i dallon qartësisht nga njësitë federale. Shteti regjional gjithashtu ngelet një formë e shtetit unitar pasi nuk njeh veçse një kushtetutë të vetme. Cilësia e dytë e regjioneve është se ato kanë një statut, pra jo një kushtetutë, dhe një **pushtet për vetëorganizim**. Ato vetë nxjerrin statutin e tyre, përmes organit përfaqësues regjional, që zakonisht quhet këshill. Kjo i dallon nga kolektivitetet e decentralizuara, statuti i të cilave është i paracaktuar me ligj nga parlamenti nacional, për secilën kategori të kolektivitetit në fjalë.[26] Edhe në nivel legjislativ ekzistojnë dallimet mes regjioneve dhe kolektiviteteve të decentralizuara: regjionet posedojnë një pushtet legjislativ burimor, të vërtetë, që ushtrohet nga një organ përfaqësues i zgjedhur në nivel regjional. Në shtetin e decentralizuar, përkundrazi, **kolektivitetet territoriale** nuk posedojnë pos një pushtet të natyrës administrative. Në këtë pikëpamje, shteti regjional afrohet dhe i ngjan shtetit federal. Për pasojë, njëjtë si në shtetin federal, në shtetin regjional hasen dy nivele të ligjvënies: legjislacioni nacional dhe legjislacioni regjional, të cilët kanë sferat e tyre të posaçme dhe të ndara të veprimit ligjvënës. Një sistem i ndarjes së juridiksionit dhe kompetencës mes dy niveleve legjislative rregullohet me kushtetutë.[27]

Shteti regjional është **bashkësi politike simetrike** që përshkohet nga një rrjet i njësive politiko-territoriale që janë afër njësive federale, por që akoma nuk kanë fituar një status të tillë juridiko-kushtetues. Në të vërtetë akoma nuk ekziston një shtjellim teorik i plotë dhe qartësisht i përpunuar i modelit të shtetit regjional, ai ka lindur në rend të parë si rezultat i kompromiseve politike në rrethanat konkrete.[28] U mor vesh, këtu e kemi

[26] Hélène Simonian-Gineste, *Droit constitutionnel en schémas*, fq. 60.
[27] Ibid., fq. 62.
[28] Për shtjellimet teorike dhe dilemat rreth përcaktimit të saktë teorik të modelit të **shtetit regjional**, cf. më shumë në Louis Favoreu, Patrick Gaïa, Richard Ghevontian, Jean-Louis Mestre, Otto Pfersmann, André Roux, Guy Scoffoni, *Droit constitutionnel*, fq. 503-522; Hélène Simonian-Gineste, *Droit constitutionnel en schémas***,** fq. 60-

fjalën për **regjionet si model i rregullimit shtetëror**, jo për regjionet në kuptim të marrëdhënieve ndërkombëtare, në të cilat zhvillohen dinamika dhe procese me aktor krejtësisht të tjerë dhe me qëllime e synime të ndryshme nga ato që studiohen në të drejtën kushtetuese.[29] Për dallim nga shteti regjional, ekziston një kuptim dhe standard tjetër juridiko-kushtetues–kuptimi i **autonomisë**, të cilin mund ta vështrojmë nga **dy kënde**. Në rend të parë, shteti regjional si një koncept i ri politik dhe juridiko-kushtetues është më i gjerë se koncepti i shtetit unitar me autonomi dhe përfshinë forma të decentralizimit të pushtetit që tejkalojnë autonominë standarde politiko-juridike. Këndi i dytë më i ngushtë i vështrimit tregon se, si formë e rregullimit shtetëror, shteti regjional është më i rrallë dhe përbën një përjashtim, një risi juridiko-kushtetuese në ndërtim e sipër dhe lidhet me krejt shtetet evropiane. **Italia** dhe **Spanja** zakonisht merren si shembuj të shtetit regjional. Një sërë shtetesh evropiane bëjnë përpjekje për futjen në rendin e tyre të brendshëm (kushtetues) të elementeve të caktuara të regjionalizimit, që nuk është asgjë tjetër veçse një emër tjetër për decentralizim, duke formuar regjione me kompetenca të caktuara, **veçanërisht në sferën e mbikëqyrjes**. Kompetencat regjionale, megjithatë, në të shumtën e rasteve janë të besuara (bartura/deleguara) nga pushteti qendror, nuk janë burimore, siç është rasti me kompetencat e bashkësive autonome politike.

Si një zgjidhje e ndërmjetme e rregullimit shtetëror, **regjionalizmi është mjet për korrektim të rregullimit ekzistues, pa prekur (ndryshuar) natyrën juridiko-kushtetuese të shtetit**. Në shtetin e ndarë në regjione, sipas rregullit, nuk ekziston prezumimi i juridiksionit dhe kompetencës në dobi të regjionit. Në **Itali**, megjithatë, ekziston një prezumim i tillë. Kjo sepse, në nenin 117 të **KIt**, taksativisht numërohen kompetencat e shtetit, që formojnë juridiksionin e Italisë si shtet, duke lënë të tjera në dobi të regjioneve. Regjionet gjithashtu nuk posedojnë të drejta të rëndësishme në sferën e vetorganizimit dhe disa cilësi të tjera të shtetësisë, siç ndodhë me njësitë federale. Shteti regjional, megjithatë, **ka synim dhe qëllim të njëjtë si shteti federal**: me të bëhen përpjekje që të bëhen të qëndrueshme dhe të arrihet paqtimi i dallimeve politike dhe dallimeve të tjera të pjesëve të ndryshme brenda shtetit. Në njërën anë, shteti regjional ruan dhe kultivon dallimet ekzistuese nëpër regjione, kurse në tjetrën siguron tërësinë shtetërore, duke mos iu dhënë regjioneve statusin e njësisë federale.

Mungesën e standardizimit juridiko-kushtetues të shtetit regjional, si formë e posaçme e rregullimit shtetëror, e konfirmojnë dispozitat e **Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Regjionale** (1997)[30] dhe të

69;Në nivel të **Komisionit të Venecias**, ka pasur një aktivitet nga **Nënkomisioni për Shtetin federal dhe Shtetin regjional**, që është zhvilluar në vitin 1997, me synim studimin e këtyre dy formave të rregullimit shtetëror me qëllim të nxjerrjes së konsekuencave teorike dhe praktike për të ardhmen e këtyre formave në truallin evropian dhe më gjerë. Pyetësori i bërë, megjithatë, ka treguar se mund të bëhet vetëm evdientimi i gjendjes dhe nuk mund të nxirren konkluzione përfundimtare teorike dhe as udhëzime me karakter normativ. Pyetësorit iu janë përgjigjur edhe vendet me rregullim shtetëror unitar, pa marrë parasysh nivelin e decentralizimit të tyre. Cf. më shumë për këtë në botimin: Venice Commission, "Federal and Regjional States". *Science and Technique of Democracy* No. 19 (CDL-STD 019: Strasbourg 1997). Në internet: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefi ndmkaj/https://www. venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile =CDLSD (1997)019-e (shikuar më 2 prill 2023).

[29] Në marrëdhëniet ndërkombëtare, termet si: regjional, dinamika dhe procese regjionale, aktor regjional dhe kështu me radhë, kanë të bëjnë me analizën e tyre në kontekstin ndërkombëtar, jo në atë vendor. Ai përdoret si koncept edhe për të krahasuar, në shkencat politike, efektivitetin e qeverisjes në pjesë të caktuara të botës, siç janë Azia, Afrika, Evropa, Amerika dhe kështu me radhë, që sërish bëhet fjala për teoretizime të shtetndërtimit në kontekstin e rolit që luajnë faktorët regjional (institucional, normativ, politik, ekonomik, fetar dhe të tjerë). Cf. më shumë për këtë në Rick Fawn, "Regions' and their study: wherefrom, what for and whereto?" *Review of International Studies* Vol. 35, *Globalising the Regional, Regionalising the Global* (February 2009), fq. 5-34; Shahar Hamieri, "Theorising regions through changes in statehood: rethinking the theory and method of comparative regionalism" *Review of International Studies* Vol. 39 Issue 2 (April 2013), fq. 313-335.

[30] **Karta Evropiane për Vetëqeverisjen Regjionale** (KEVR) përfaqëson një kushtetutë specifike për regjionet evropiane, e cila definon statusin, organizimin dhe operimin e tyre. Është miratuar në seksionin e katërt të **Kongresit të autoriteteve lokale dhe regjionale të Këshillit të Evropës** më 3-5 qershor 1997 në Strasburg. **KEVR** definon rregullat kushtetuese të vetëqeverisjes së autoriteteve regjionale, qëllimet e tyre dhe mekanizmat e veprimit. Dispozitat më të rëndësishme të paraqitura aty, përfshijnë ato që kanë të bëjnë me fushat për sa vijon: forcimi i bashkëpunimit mes shteteve anëtare me qëllim të realizimit të parimeve për respektim të të drejtave të njeriut dhe demokracisë, zbatimit të të drejtave të qytetarëve për të marrë pjesë drejtpërdrejtë në punët publike; implementimin e parimit të subsidiaritetit dhe veprimeve të drejtuara kah ndërtimi i pozitës së regjionit si një element esencial i shtetit në sistemin e demokracisë territoriale dhe për kënaqjen e nevojave të qytetarëve. Objektivi themelor

Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale (1985), të cilat ngërthejnë parime të ngjashme të decentralizimit. Ato bazohen në përpjekjet për të ruajtur cilësinë e atillë të pushtetit që i rrinë pranë qytetarit dhe shpie në shpërndarjen e pushtetit dhe demokratizimin e shtetit. Në këtë drejtim, Kuvendi i regjioneve evropiane, mbajtur në **Bazel** (1996) dhe në **Udine** (2007) ka miratuar akte me të cilat u propozuan modele për tejkalim të kundërthënieve brenda shteteve, me qëllim të ruajtjes së identitetit regjional, shtetëror dhe evropian, homogjenizim të kulturave të ndryshme dhe përballimit të sfidave të migracionit të popullsive që nuk kanë identitet të njëjtë. Aktet ndërkombëtare, pra, e shohin **shtetin regjional si bashkësi politike në të cilën duhet të ruhet identiteti regjional**, si dhe diversiteti nacional, kulturor, gjuhësor dhe historik, por jo në llogari të identitetit nacional dhe tërësisë së shtetit.

Me të drejtën e brendshme në mënyrë të detajuar rregullohet statusi i regjionit, në mënyrën që i përgjigjet specifikave të shtetit konkret. Pushteti qendror me kushtetutë e ligje normon statusin e regjionit, të drejtat dhe detyrimet, në disa raste edhe bazat (themelet) e organizimit të pushtetit regjional. Me kushtetutë e ligje gjithashtu garantohet dhe sigurohet vetëqeverisja e regjioneve dhe përcaktohet konkretisht se nga cilat të drejta përbëhet e njëjta. Kushtetutat e **Italisë** dhe **Spanjës**, në një masë të madhe (Italia) ose më të vogël (Spanja), kanë lënë prapa rregullimin e vjetër shtetëror, duke bërë një hap të përpara dhe vendimtar në drejtim të demokratizimit në raport me regjimet e vjetra dhe të degraduara. Italia e dikurshme fashiste kishte humbur në **Luftën e Dytë Botërore** dhe ndiente nevojën e domosdoshme për një rend demokratik dhe formë të re të rregullimit shtetëror. Shteti u gjet pranë dilemës: shtet unitar me një decentralizim të theksuar, ose federatë. Me **KIt** u nis procesi i decentralizimit me krijimin e njësive autonome – regjioneve ("regioni"). Më këtë hap u shmang federalizimi i shtetit, që ka mund të jetë potencialisht me rrezik të madh për integritetin e shtetit, nisur nga fakti se siujdhesa **Apenine,** historikisht shikuar, deri në gjysmën e dytë të shek. XIX ka qenë e ndarë në disa shtete dhe entitete të vogla politike.[31] Regjionet italiane gëzojnë autonomi politike, kanë kompetenca burimore dhe të bartura (deleguara), disa punë i ndajnë me pushtetin shtetëror qendror. Regjionet nuk kanë elementet e shtetësisë të rangut të njësisë federale–nuk kanë kushtetutë, as pushtetin e tyre gjyqësor. Mes tyre, megjithatë, ekzistojnë disa ngjashmëri. Kështu, në secilin regjion zgjedhet një numër i caktuar i senatorëve, nga një deri në dyzetë e nëntë, në zgjedhjet për dhomën e sipërme të parlamentit, Senat ("Senato della Repubblica"). Regjionalizimi i Italisë deri diku është asimetrik, për shkak se **pesë regjionet** e saj gëzojnë një status special (**Aosta** Vallery, Friuli-Venezia Giulia, Sardinia, Sicily dhe Trentino-Alto Abdige/Sudtironl).

Spanja ka pasur arsye dhe rrethana të ngjashme historike që kanë çuar deri te regjionalizimi kushtetues i shtetit. Me përfundimin e sundimit autoritar të gjeneralit **Francisko Franko** (Francisco Franco: 1892-1985, ka sunduar nga viti 1935 deri në vitin1975), Spanja u gjet në udhëkryq sa i për-

i **KEVR** është të kërkoj dhe gjej elementet e përbashkëta regjionale që ekzistojnë në shtetet e ndryshme, në ndërkohë që ruhen dallimet lidhur me zgjidhjet sistemike dhe të detajuara. Regjioni është njohur dhe veçuar si një nivel i autoritetit, për të cilin gjithashtu duhet të vlejë parimi i subsidiaritetit me mbrojtjen simultane të vetëqeverisjes lokale. Në këtë mënyrë, **KEVR** i referohet drejtpërdrejtë Kartës evropiane për vetëqeverisjen lokale **(KEVL)** dhe qartë thekson implementimin reciprok të dy akteve. Si bazë, **KEVL** njeh parimin e vetëqeverisje regjionale, që duhet të pranohet në kushtetutat e shteteve në shkallën më të gjerë të mundshme. Definimi i vetëqeverisjes regjionale përfshihet në nenin 3.1 të **KEVR**, dhe nënkupton për si vijon: "Vetëqeverisja regjionale nënkupton të drejtën dhe mundësinë e autoriteteve më të mëdha territoriale brenda secilit shtet, që kanë trupa të zgjedhura, administrativisht janë të vëna ndërmjet qeverisë (pushtetit) qendror dhe autoriteteve lokale dhe gëzojnë prerogativat ose të vetorganizimit ose të llojit të atillë që normalisht asocohen me pushtetin qendror për të menaxhuar, në përgjegjësi të tyre dhe për interesat e popullatës të tyre, një pjesë të konsiderueshme të çështjeve publike, në pajtim me parimin e subsidiaritetit".

31 Për dilemat dhe debatet në **Asamblen**ë Kushtetuese të Italisë, që draftoi dhe miratoj **KIt**, vecanërisht sa i përket çështjes së **federalizimit të vendit**, cf. më shumë në McGaw Smyth, Howard (September 1948). "Italy: From Fascism to the Republic (1943-1946)". *The Western Political Quarterly* Vol. 1 No. 3 (September 1948), fq. 205–222; Robert H. Evans and Felice Rizzi, "Local Autonomies, Regional Governments and Metropolitan Areas in Italy" *The Review of Politics* Vol. 40, No. 1 (January 1978), fq. 58-76. Simone Pajno, "Regionalism in the Italian Constitutional System" *Diritto et Questioni Pubbliche* No. 9 (2009), fq. 625-642 në fq. 626-627; Carlo Salone, "Questioning New regionalism from an Italian perspective, or the resistible rise of Italian regions" *Pôle Sud* Vol. 1 No. 46 (2017), fq. 43-61 në fq. 45-53.

ket formës së qeverisjes (të ruhet monarkia apo të futet republika), por edhe në raport me formën e rregullimit shtetëror. Kësaj dileme, më shumë se ndarjet historike, politike, gjuhësore dhe nacionale të siujdhesës **Pirineje**, i ka kontribuar pakënaqësia e disa popujve në Spanjë –baskëve, katalonasve por edhe në një sërë fushash të tjera që gjatë kohës së sundimit autoritar ishin shpërdoruar dhe sunduar si mos më keq. Me **KSp**, u gjet zgjidhja e ndërmjetme mes decentralizimit dhe federalizimit të vendit, në atë mënyrë që u krijua baza kushtetuese për formimin e regjioneve me emrin "bashkësitë autonome" ("comunidad autonoma"), në territorin e krejt shtetit (ekzistojnë edhe dy qytete autonome jashtë **Spanjës**, si dhe territore ishullore sovrane).[32]

As ky shtet regjional nuk është tërësisht simetrik, për shkak se **tri bashkësitë autonome** gëzojnë **status të posaçëm**, për shkak të specifikave nacionale, gjuhësore dhe historike (**Baskia**, **Galicia** dhe **Katalonia**). Bashkësitë autonome përfaqësohen dyfish në dhomën e sipërme të parlamentit, në **Senat** ("Senado"): kuvendet e tyre delegojnë senatorët, nga një në një milion banorë, kurse një numër i tyre zgjedhet drejtpërdrejtë nga ana e qytetarëve në bashkësitë autonome (nga katër në secilën prej 50 provincave në të cilat ndahen bashkësitë autonome). Nga njësitë federale dallohen sepse nuk kanë kushtetutat e tyre dhe për shkak se shteti jep pëlqimin për aktin më të lartë juridik regjional–statutin. Bashkësitë autonome po ashtu nuk kanë organet e drejtësisë (gjyqet dhe prokuroritë).

Regjionalizimit të **Italisë** dhe **Spanjës**, përveç arsyeve politike që lidhen me daljen e shtetit nga një sundim totalitar dhe autoritar dhe kalimit të tij në një demokraci kushtetuese, i kanë kontribuar edhe faktorë të tjerë, siç janë: përbërja multietnike e popullsisë, gjuha e ndryshme nga gjuha e popullit shumicë, identiteti kulturor, cilësitë historike, gjeografike dhe ekonomike të pjesëve të caktuara të shtetit.

5.2. Emërtimet e ndryshme dhe themelimi i regjioneve

Për njësinë e **autonomisë politiko-territoriale** në nivelin menjëherë pas pushtetit (qendror) shtetëror **përdoren emërtime të ndryshme**, siç janë: **provincë**, **autonomi**, **qytet**, **regjion**, **krahinë**, **zhupani**, **dukatë**, **rreth (qark)**, **bashkësi autonome**.[33] Këto regjione dallohen mbi bazën e pozitës së tyre juridiko-kushtetuese, juridiksionit dhe kompetencës, procedurave juridike dhe në përgjithësi shkallës së autonomitetit të tyre. Vetë regjioni, në përshkrimin si më sipër, duhet të dallohet nga kuptimet dhe shprehjet që përdoren në jetën e përditshme, siç janë, ta zëmë: regjioni i një qyteti, regjioni i Ballkanit, Evropës qendrore, Detit të Zi etj. Konceptet mikro (qyteti), mezo (territori në shtet, brenda tij), makro (shumë shtete ose pjesë të shteteve) dhe, në fund, regjionet globale (pjesë të kontinenteve), nuk tregojnë njësinë e decentralizimit por përdoren për qëllime nga më të ndryshmet, shpesh herë jashtë kontekstit të së drejtës kushtetuese dhe të së drejtës në përgjithësi.
Brenda shtetit mund të dallohen **tri koncepte të decentralizimit**, nga të cilat vetëm njëri ka natyrë juridiko-kushtetuese. Ky koncept që ka **relevancë juridiko-kushtetuese**, jo vetëm pse normohet nga kjo degë e së drejtës, por për faktin se nënkupton që në regjion ekziston një organ i të drejtës publike që ka pushtet të caktuar politik. Regjioni i tillë është njësi e **autonomisë politiko-territoriale** dhe **pjesë e ndarjes vertikale të pushtetit**, në nivel mbi vetëqeverisjen lokale. Sa më i zhvilluar regjionalizimi, aq më shumë autonomi do të realizoj regjioni në raport me pushtetin qendror dhe do të ketë juridiksion e kompetencë dhe status juridiko-kushtetues që e dallon qartësisht nga njësitë e vetëqeverisjes lokale. Ky, pra, është **koncepti i parë i regjionalizimit**.

---

[32] Cf. më shumë në Stanley G. Payne, "Nationalism, Regionalism and Micronationalism in Spain *Journal of Contemporary History*" Vol. 26 No. 3/4 (September, 1991), fq. 479-491; Juan Pablo Fusi, "2. Regionalism and nationalism in contemporary Spain" *RSA Journal* Vol. 142 No. 5452 (August/September 1994), fq. 48-54; Carsten Jacob Humlebæk, "Political and territorial construction of regional and national identities in Spain since 1978" *L'Europe en Formation* Vol. 1 No. 379 (2016), fq. 58-76.

[33] Cf. më shumë për të gjitha llojet e autonomive, politiko-territoriale dhe jo-territoriale, në aspektin aktual dhe historik, në përmbledhjen e shkëlqyer Brian C. H. Fong and Atsuko Ichijo, *The Routledge Handbook of Comprative Territorial Autonomies* (Routledge: London and New York, 2022).

Koncepti i dytë i regjionalizimit është ai në të cilin **ekzistojnë regjionet administrative**, të cilat nuk kanë identitet të posaçëm politik. Në këto raste shteti ua beson regjioneve disa punë, kryerja e të cilave në çdo kohë mund të revokohet. Në këto regjione ekzistojnë edhe organe shtetërore, jashtë selisë së tyre, që kryejnë punët shtetërore me qëllim të pasjes së një administrate sa më efikase (**parimi i dekoncentrimit**). Ky koncept e afron regjionin më afër statusit juridiko-kushtetues të vetëqeverisjes lokale. Këtu ekzistojnë dy nëngrupe të regjioneve: në grupin e parë hyjnë ato regjione që janë pjesë e vetëqeverisjes lokale (Gjermania, Suedia etj.), kurse në të dytin regjionet që janë krijuar nga lartë, nga ana e pushtetit qendror, por që nuk kanë ndonjë juridiksion ose kompetencë cilësore që do t'i bënte të dallueshme nga vetëqeverisja lokale, së cilës po ashtu nuk i nënshtrohen (Franca, Portugalia, etj).

Koncepti i tretë i regjionalizimit është **zhvillimor-statistikor**, i cili përbëhet nga regjionet e Evropës, si njësi zhvillimore-statistikore të ndara në kategori sipas klasifikimit të **BE**-së. Këtu e kemi fjalën për "Nomenclature of Territorial Units for Statistics", apo **NUTS** nga shkurtesa nga versioni frëngjisht "Nomenclature des Unités territoriales statistiques", e cila është një nomenklature gjeografike që bën nënndarjen e territorit ekonomik të BE-së në regjione të tri niveleve (NUTS 1, 2 dhe 3 respektivisht, duke u nisur nga njësitë më të mëdha kah ato më të vogla). Mbi NUTS 1 gjendet "niveli nacional" i shteteve anëtare të BE. Puna e NUTS bazohet në Rregulloren e BE-së No. 1059/2003 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian të datës 26 maj 2003 mbi themelimin e klasifikimit të përbashkët të njësive territoriale për statistika (NUTS), që azhurnohet rregullisht. Pas NUTS, e rëndësishme është edhe puna e **EUROSTAT** ("Eurpean Statistical Office"), drejtorisë së përgjithshme të Komisionit Evropian, që ka selinë në **Luksemburg**, i cili ndan Evropën në rreth 1.700 regjione në kategorinë 1 (nga tre deri në shtatë milion banorë), kategorinë 2 (800.000 deri në tre milion banorë) dhe kategorinë 3 (150.000 deri në 800.000), Sipas **EUROSTAT** ekzistojnë edhe kategoritë **LAU** 1 (rrethet apo qarqet) dhe **LAU** 2 (komunat). **LAU** është shkurtesë për "Local Administrative Units" ("njësitë administrative lokale"). Sikundër shihet, këtu nuk kemi decentralizim, por në regjion kryhen punë që nuk janë vendimmarrje politike, por vetëm mbledhje dhe përpunim i të dhënave që i shërbejnë statistikës dhe zhvillimit në fushat e arsimit, shkencës, ekonomisë dhe fushat tjera.

Regjionet si njësi të **autonomisë politike** themelohen me kushtetutë (**Italia**). Në raste të tjera, me kushtetutë vetëm garantohet e drejta për vetëqeverisje regjionale dhe normohet procedura e formimit të regjioneve (**Spanja**). Në të njëjtën kohë, me kushtetutë garantohet mbrojtja nga pushteti qendror në rast se provon të ndryshoj statusin e regjionit ose të zvogëloj të drejtat e tij. Regjionet që janë njësi administrative (në **Francë**, **Britaninë e Madhe** etj.), pra jo njësi të autonomisë politike-territoriale, paraqesin një kategori ligjore: themelohen me ligj dhe gradualisht marrin disa kompetenca dhe funksione. Regjionet e themeluara në këtë mënyrë janë rezultat i përshtatjes së organizimit aktual territorial me procesin e regjionalizimit, në të cilin nuk krijohen subjekte të reja politiko-autonome. Shembulli më i mirë i kësaj është **Franca**, në të cilën pas **Luftës së Dytë Botërore** janë rritur kërkesat për regjionalizim, që më vonë u realizua me ligjin e vitit 1982, për t'u zhvilluar tutje deri te reformat e vitit 2004, aktualisht në fuqi. Regjionet kanë marrë funksionet e planifikimit ekonomik dhe kompetencat e policisë, arsimit, kujdesit social, por kanë edhe organet e tyre të pushtetit (perfektin regjional, i cili është zyrtar i qeverisë, si dhe një trup përfaqësues që zgjidhet drejtpërdrejtë).[34] Ndryshe, **Franca** llogaritet si një shtet i centralizuar dhe i metropolizuar, në njërën anë është **Parisi** kurse në tjetrën gjendet "provinca".

Arsyet për krijimin e regjioneve si njësi të veçanta politiko-territoriale janë të ngjashme me arsyet e krijimit të njësive federale. Regjionet kanë cilësi të posaçme nacionale dhe etnike, gjeografike,

[34] Cf. më shumë në Arundhati Virmani, "Regionalism in France". *Proceedings of the Indian History Congress* Vol. 48 (1987), fq. 675-685; Timothy Baycroft, "National Diversity, Regionalism and Decentralism in France". Në Joost Augusteijn, Eric Storm (eds), *Region and State in Nineteenth-Century Europe* (Palgrave Macmillan, London, 2012) fq. 57-68.

kulturore, ekonomike, fetare ose gjuhësore, mirëpo janë arsyet politike ato që mbizotërojnë kundër federalizimit të shtetit. Kështu, ta zëmë, ishujt **Aland** plotësojnë më shumë kriteret për fitimin e statusit të regjionit me autonomi politike në kuadër të **Finlandës**, të cilat në të njëjtën kohë nuk mjaftojnë për fitimin e statusit të njësisë federale. Ato janë, siç vijon: pozita gjeografike (ishuj), veçantia gjuhësore (shumica dërrmuese e popullsisë flasin suedisht), pozita ndërkombëtare dhe dallimet historike (nën sundimin suedez dhe rus një kohë të caktuar). Arsyet për autonominë e **Grenlandës** në Danimarkë janë të shumta: gjeografike dhe klimatike, etnike (një komb i veçantë arktik, historikisht, ekonomikisht dhe në aspektin kulturor). Këto dy shtete nuk plotësojnë kushtet që i kanë vënë Italia dhe Spanja, në të cilat vetëm një pjesë e territorit shtetëror ka statusin e autonomisë regjionale (në Danimarkë edhe ishujt **Faroe** kanë statusin e njëjtë).

5.3. Organizimi i pushtetit, kompetencat dhe mbrojtja juridike e vetëqeverisjes regjionale

Brenda regjionit ekziston organizimi i pushtetit, i cili përbëhet nga organet regjionale. Organet regjionale miratojnë aktet juridike me fuqi ligjore dhe nënligjore, kurse si akte të fuqisë më të madhe juridike që zbatohen në nivel regjioni janë kushtetuta dhe ligjet e shtetit. Në shtetet individuale ekzistojnë dallime në raport me këtë përshkrim të përgjithshëm.

Organizimi i pushtetit në regjion përfshinë organet si vijon: **organin përfaqësues**, që qëndron kundruall parlamentit nacional brenda shtetit, pastaj **organet që kanë funksionin e ekzekutivit**, ngjashëm me qeverinë, dhe **organet regjionale të administratës**. Regjionet nuk kanë gjykatat e tyre vetjake regjionale, dega e pushtetit gjyqësor ngelet unike për krejt territorin e shtetit, përkatësisht shtetërore.

Konform nevojës për përafrim të pushtetit ndaj qytetarit, **organi përfaqësues** regjional zgjedhjet me votë të drejtpërdrejtë të qytetarëve të regjionit. Sipas strukturës, ky organ është njëdhomësh dhe miraton aktet e përgjithshme të cilat i ekzekutojnë bartësit e funksioneve ekzekutive dhe administrative në regjion, si dhe organet e vetëqeverisjes lokale në territorin e regjionit. Parlamenti regjional ose trupi regjional përfaqësues miraton aktin më të larët të regjionit, i cili zakonisht quhet statut, në mënyrë të pavarur së bashku me organet e pushtetit qendror. Statuti duhet të jetë në pajtim me kushtetutën dhe ligjet e shtetit dhe i nënshtrohet vlerësimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë nga ana e organeve qendrore të pushtetit. Organi përfaqësues regjional mund të ketë edhe juridiksion dhe kompetencë ligjvënëse. Në këto raste, regjioni miraton ligje nga fushat e përcaktuara me kushtetutë dhe ligje qendrore, ose me statut në pajtim me kushtetutën.

Organin ekzekutiv regjional (qeverinë, këshillin, pleqësinë) e zgjedhë organi përfaqësues regjional, kuvendi ose parlamenti, para të cilit përgjigjet politikisht. Sa i përket funksionit të tij ekzekutiv, qeveria regjionale ekzekuton dispozita që miraton organi regjional përfaqësues, por edhe dispozitat e pushtetit qendror. Në këtë kuptim, organi përfaqësues regjional mund të konstatoj ekzistimin e përgjegjësisë së qeverisë regjionale dhe të shkarkoj të njëjtën, kurse pushteti qendror ka të drejtën e mbikëqyrjes, që përfshinë edhe autorizimin për ndalimin e ekzekutimit të dispozitave ose anulimin e aktit jokushtetues dhe joligjor të autoriteteve regjionale.

Regjioni ka administratën vetjake, pozita e së cilës normohet në rend të parë me aktet regjionale, mbi bazën e përcaktimeve të vëna në kushtetutën dhe ligjet e shtetit. Organizimi i administratës regjionale, juridiksioni dhe kompetenca, çështjet kadrovike dhe financat, bijnë në domen të pushtetit regjional. Administrata regjionale qëndron menjëherë pas qeverisë regjionale, e cila ndaj saj ushtron autorizime organizative, mbikëqyrëse dhe kadrovike, vetëm ose së bashku me organin regjional përfaqësues.

Regjionet shumë rrallë kanë pasur pushtetin vetjak gjyqësor, me kuptim pushtetin gjyqësor hierarkik që do të qëndronte nën gjykatën supreme vetjake, si gjykata me e lartë në regjion. Në disa regjione italiane, si në **Sicili,** dikur ka ekzistuar pushteti gjyqësor i ndarë, që më nuk ekziston.[35] Njëjtë edhe në **Spanjë**, regjionet nuk kanë të drejtë që, krahas gjykatave ekzistuese shtetërore, të formojnë gjykatat e tyre: Gjykata Supreme e Drejtësisë e Katalonisë (**Tribunal Superior de Justicia de Catalunya**) është gjykatë shtetërore, jo gjykatë regjionale. Parimi regjional në zgjedhjen e gjyqtarëve nga regjioni në territorin e së cilit shtrihet juridiksioni dhe kompetenca e gjykatës, përfaqëson një lloj lidhjeje mes regjionit dhe pushtetit gjyqësor. Regjionet po ashtu nuk kanë organin që do të ushtronte kontrollin e kushtetutshmërisë, këtë funksion e ushtron gjykata shtetërore kushtetuese, e cila mbron të drejtat regjionale, si në raport me konfliktin për kompetencë me shtetin, ashtu edhe në raport me regjionet tjera dhe vetëqeverisjen lokale.

Juridiksioni dhe kompetencat e regjionit përfshijnë punët burimore, si dhe punët të cilët pushtetit qendror i përcakton si punë që do të kryhen në nivel regjional. Kjo përcaktohet me aktet juridike të pushtetit qendror dhe regjional: kushtetuta, ligji, statuti, ligjet regjionale (nëse regjioni ka autorizim për nxjerrjen e tyre), si dhe e drejta ndërkombëtare e pranuar nga ana e shtetit. Për aq sa pushteti regjionial, në krahasim me pushtetin qendror, afrohet më afër me qytetarin, zgjerimi i kompetencave dhe bartja e punëve shtetërore në regjion, përveç realizimit të kërkesës për decentralizim, merr edhe një dimension demokratik. Shteti dhe regjioni mund të normojnë së bashku një fushë, juridiksion, kompetencë, çështje juridike. Në një rast të tillë pushteti qendror normon themelet apo bazat, kurse regjionet me dispozitat e tyre operacionalizojnë dhe përpunojnë më tutje këto themele ose baza, duke i përshtatur ato ndaj nevojave vetjake. Ta zëmë, shteti në parim normon të drejtën për arsimin e lartë, themelimin dhe autonominë e universitetit, kurse regjionet këto dispozita i përpunojnë duke specifikuar se cilat të drejta formojnë të drejtën për arsimin e lartë, cilat janë elementet konkrete të autonomisë së universitetit.

Numri dhe cilësia e juridiksionit dhe kompetencave që i ka pushteti regjional varen nga shkalla e **decentralizimit politik**, përkatësisht nga gatishmëria e shtetit për të realizuar ndarjen vertikale të pushtetit. Sa më e madhe gatishmëria e shtetit për një gjë të tillë, aq më shumë kompetenca burimore dhe esenciale do të kenë regjionet. Juridiksioni dhe kompetencat e regjionit përcaktohen nga pushteti qendror me numërim taksativ të fushave dhe punëve që kryhen në nivel regjioni. Ato janë zakonisht punë dhe fusha që regjionet i kryejnë në mënyrë më efikase dhe kanë rëndësi për regjionin, siç janë: planifikimi dhe zhvillimi, politika ekonomike, komunikacioni, energjia, mjedisi jetësor, bujqësia, turizmi, sporti, policia, rendi publik. Këto më tutje përpunohen me akte të regjionit, në mënyrë të detajuar. Kompetenca e regjionit ka të bëj edhe me lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare me regjionet e shteteve të tjera në fushat që bien nën juridiksionin dhe kompetencën e tyre, me qëllim të nxitjes së bashkëpunimit mes institucioneve shkencore dhe kulturore, subjekteve ekonomike, këmbimit të arsimtarëve dhe studentëve, ruajtjes së mjedisit jetësor etj.

[35] Me nenin 23 të **Statutit të Sicilisë** të vitit 1946, aktualisht në fuqi, përcaktohet që organet gjyqësore të Italisë kanë seksionet e tyre respektive që kanë të bëjnë me regjionin e **Sicilisë**. Statuti është ratifikuar më dekretin mbretëror nr. 455 të datës 15 maj 1946, një vit e gjysmë para miratimit të **KIt**. Më pastaj është shndërruar në ligj kushtetues më datën 26 shkurt 1948. Ndryshimet dhe plotësimet e fundit të tij janë bërë më 2001. Me nenin origjinat 24 të Statutit u pat themeluar **Gjykata e Lartë e Sicilisë** (GJLSi), me seli në **Romë**, e cila ka pasur të drejtën e kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve të Asamblesë Regjionale të Sicilisë (ARSi), ligjeve dhe rregulloreve të **Parlamentit të Italisë** që kanë pasur të bëjnë me Regjionin e Sicilisë (RSi), përfshirë dhe vlerësimin e efekteve të tyre brenda këtij regjioni (neni 25 i Statutit). Krahas kësaj kompetence, **GJLSi** ka pasur kompetencë penale edhe ndaj veprave të kryera nga **Presidenti i Regjionit** dhe disa prej funksionarëve të tjerë regjional (neni 26 i Statutit), si dhe juridiksion apeli për ligjet e miratuara nga **ARSi** (nenet 28 dhe 29 të Statutit). Të gjitha këto kompetenca të **GLSi** janë shpallur nule dhe të pavlefshme, në mënyrë graduale nga viti 1957 deri në vitin 1989, nga **Gjykata Kushtetuese e Italisë** (GJKIt), gjatë kontrolli incidental të legjitimitetit kushtetues të dispozitave të Statutit të Sicilisë. Cf. *Statute of the Sicilian Regional Government* (Siçily Region: Presidency). Në internet: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglcl efindmkaj/https://www.regione.siçilia.it/sites/default/files/2020-10/Statute%20of%20the%20Siçilian%20Regional%20Government.pdf (shikuar më 26 prill 2023). **GJLSi** duhet të dallohet nga **Gjykata e Lartë e Parlamentit**, e themeluar sipas **Kushtetutës së Sicilisë** të vitit 1812, shumë kohë para unifikimit të **Italisë** (1871). Kjo gjykatë ka qenë penale dhe ka pasur juridiksion për të gjykuar zyrtarët e lartë të Mbretërisë së Sicilisë. Cf. më shumë për këtë në Vittoria Calabro, "1812–15: The debate about the High Court of the Sicilian Parliament". *Parlaments, Estates and Representation* Vol. 33 Issue 1 (2013), fq. 34-44.

Sipas shkallës së pavarësisë që ka regjioni në ushtrimin e juridiksionit dhe kompetencave të tij, ato ndahen në **burimore** dhe të **bartura**. Punët burimore pushtetit qendror nuk mund t'i kufizoj, ato përfaqësojnë thelbin e autonomisë regjionale. Ajo në çka merr pjesë shteti këtu ka të bëjë me bashkëfinancimin, duke iu përmbajtur parimit të zhvillimit të balancuar dhe proporcional të regjioneve. Punë të besuara konsiderohen ato që shteti i bartë (kalon me besim) në regjion dhe mban të drejtën e mbikëqyrjes së ligjshmërisë dhe oportunitetit të punëve të tilla. Shteti ka të drejtën e kthimit prapa të këtyre punëve, sepse ruan kompetencën për ushtrimin e tyre në çdo kohë. Mirëpo, në kohën e kryerjes së tyre nga regjioni, shteti ka detyrim për të financuar kryerjen e tyre.

Sa i përket financimit të organeve të pushtetit dhe të punëve, synim parësor është që regjioni të ruhet si **një tërësi e qëndrueshme ekonomike**. Kjo nënkupton që regjioni, si njësi e politike e vetëqëndrueshme, duhet sa më shumë financiarisht të pavarësohet financiarisht nga shteti. Në realitet, për arritjen e këtij synimi nuk kanë potencial shumica e regjioneve. Regjionalizimi shkakton shpenzime të mëdha materiale, në rend të parë shpenzime të administratës regjionale, për këtë arsye është e domosdoshme bashkëfinancimi nga shteti. Ky bashkëfinancim, megjithatë, ngritë çështjen e qëndrueshmërisë së autonomisë politike regjionale, marrë parasysh varshmërinë ndaj shtetit dhe ndikimin politik që krijohet si pasojë e mbështetjes financiare shtetërore. Qeverisja regjionale është e pandashme nga autonomia financiare, që nënkupton se regjioni ka edhe të **ardhura vetjake** me të cilat disponon lirisht në mënyrë të pavarur. Autonomia financiare garantohet me kushtetutë ose ligj dhe nënkupton që regjionet marrin një pjesë të tatimeve që mbledh shteti (**Spanja**), mund të caktojnë tatime e taksa regjionale dhe të kenë përqindje shtesë në tatimet që veç mblidhen nga shteti, në pajtim me kushtetutën dhe ligjin (**Italia**). Përveç kësaj, si persona juridik, regjionet kanë qasje të njëjtë në **tregun e kapitalit** dhe **mund të marrin kredi**, **të futen në borxh** (të kreditohen), që gjithashtu përfaqëson një formë të financimit. Bashkëpunimi ndër-regjional, brenda dhe jashtë shtetit, përfshinë edhe **bashkëpunimin dhe ndihmën financiare**.

Mbrojtja e vetëqeverisjes regjionale është e domosdoshme për shkak se shteti mund të bëj përpjekje për rritje ose shtrëngim të kontrollit ndaj pushtetit regjional, apo që përmes akteve të ngushtoj fushat që dominohen nga juridiksioni dhe kompetenca regjionale dhe, me këtë, të zhvesh nga pushteti regjionin. Jo rrallë, qëllimet politike të shtetit dhe regjionit janë në kundërshtim reciprok, prandaj të pritshme dalin situatat në të cilat cenohen dhe ngushtohen të drejtat e regjionit dhe, pak më rrallë, edhe anasjelltas.

Me qëllim të mbrojtjes së pozitës juridiko-kushtetuese, juridiksionit dhe kompetencës konkrete të regjionit, krijohen **instrumente juridike** që i mundësojnë të njëjtit nisjen e procedurave pranë gjykatës kompetente. Shteti gjithashtu ka të drejtën e nisjes së procedurës me qëllim të vërtetimit nëse një akt ose veprim konkret regjional është në pajtim me kushtetutën dhe ligjin. Organi që zgjidh kontestet mes regjionit dhe shtetit është **gjykata kushtetuese** (Italia, Spanja).[36] Mund të jetë edhe gjykata tjetër me juridiksion dhe kompetencë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve për kompetencë në nivel nacional.

Autonomia regjionale mbrohet edhe përmes përcaktimit të detyrimit të pjesëmarrjes së regjionit në procedurat e caktuara. Regjioni mund të ketë vetëm **rol konsultativ**, në rastet kur mendimi i tij merret në dijeni dhe pa ndonjë detyrim. Këto janë situatat kur ndryshohen disa kompetenca ose çështje të tjera statusore, siç është, ta zëmë, zvogëlimi i pushtetit ligjvënës të regjionit, i cili ka qenë i përcaktuar me kushtetutë ose ligj të shtetit. Nga përfaqësuesit regjional do të merret mendimi këshillëdhënës mbi ndryshimin e propozuar, kurse regjioni edhe tërthorazi, përmes përfaqësuesve të vet në parlament (përfaqësues nga territori i regjionit), mund të marrin pjesë në procedurën e tillë për ndryshim. Kjo është kështu sepse, në parim, regjionet nuk marrin pjesë në miratimin dhe amendamentimin e kushtetutës nacionale.[37] Nëse bëhet fjalë për procedurën e ndryshimit të territorit, gjerat ndryshojnë, qoftë kur flitet

[36] Hélène Simonian-Gineste**,** *Droit constitutionnel en schémas*, fq. 64.
[37] Hélène Simonian-Gineste**,** *Droit constitutionnel en schémas*, fq. 64.

për zvogëlimin, rritjen bashkimin e regjioneve ose ndarjen e tij në disa regjione. Në këto raste **kërkohet pëlqimi i regjionit**, që jepet përmes organeve regjionale ose përmes vullnetit të shprehur të qytetarëve të tij. Ky **pëlqim i detyrueshëm** vlen vetëm për konceptin e **regjionit politik**, pra kur regjioni është formë e shtetit (shteti regjional), kurse për forma tjera të **njësive regjionale** nuk është i detyrueshëm (në Francën metropolitane me ligj janë zmadhuar regjionet, nga 22 sosh sa kanë qenë më 1982, në reformën e parë, në vitin 2016 janë krijuar 13 sosh, sa janë edhe aktualisht, krahas pesë regjioneve përtej detit).

6. Shteti regjional në Kosovë dhe vendet fqinje

6.1. Kosova

Në Kosovë dhe në vendet fqinje, nëse ekziston ose jo një autonomi territoriale duhet gjykuar ekskluzivisht në aspektin juridiko-kushtetues, asnjëherë mbi bazën e parametrave ose karakteristikave të tjera. Dimensionet tjera të autonomitetit dhe pavarësisë së grupeve të caktuara shoqërore dhe territoreve brenda shtetit janë objekt interesimi i degëve të tjera të së drejtës dhe shkencave të tjera. Këtë qasje kemi ndjekur më sipër, kur kemi definuar të gjitha modelet e shtetit, si përcaktues të ndarjes vertikale të pushtetit.

Me **Kushtetutën e Kosovës** (KKos), miratuar më 9 prill 2008, aktualisht në fuqi që nga 15 qershorit i vitit 2008, vendi definohet si shtet unitar, me një decentralizim të theksuar që bazohet në **Planin Ahtisari** (2007), dispozitat e të cilat **KKos** i ka përbrendësuar në tërësi, për t'i operacionalizuar tutje me ligje dhe aktet të tjera juridike që normojnë rolin dhe pozitën e komuniteteve të Kosovës. Ky decentralizim i theksuar, që ka nisur më 2002 dhe duke pasur për bazë **Planin Ahtisari**, në rend të parë ka pasur të bëj me **serbët lokal**, të cilët janë përfituesit e tij më të mëdhenj. Themelimi i komunave të reja në Kosovë në vitet 2002-2008, përkundër numrit të madh të tyre, nuk ka arritur të prish karakterin unitar të **Shtetit të Kosovës**, i cili, deri në momentin e shkuarjes së këtyre rreshtave (prill 2023), vazhdon të ngelet shtet unitar me decentralizim të theksuar të nivelit komunal.[38] Kjo gjendje, megjithatë, ka nisur të vihet në dyshim me Marrëveshjen e vitit 2013 mes Kosovës dhe Serbisë (MA 2013), e operacionalizuar në korrik të vitit 2015 me një marrëveshje tjetër (MA 2015), përfundimisht e ngritur në nivel të detyrimit **super-kushtetues** me **Marrëveshjen e Ohrit** (MO) të datës 18 mars 2023, e cila ka futur të gjitha detyrimet ndërkombëtare të Kosovës lidhur me pozitën specifike dhe të veçantë të serbëve lokal, kishave dhe trashëgimisë së tyre kulturore, nën **ombrellën juridike** (nën regjimin juridik-kushtetues) të **BE**.[39] Sipas nenit 7.1 të **MO** Kosova detyrohet të krijoj një "nivel të duhur të

[38] Aktualisht janë 38 komuna, nga të cilat dhjetë janë të udhëhequra nga serbët lokal, kurse një nga komuniteti turk i Kosovës. Gjithsej 25% e krejt komunave udhëheqen nga komunitetet pakicë. Cf. më shumë në Adem Beha, "Decentralisation in Kosovo: A Challenge to Deal With?". *Journal of Peace, Conflict and Development* Vol. 1 Issue 17 (August 2011), fq. 23-42; Samet Dalipi and Krenar Shala, *The Role of Decentralization on Security Improvement and Peace – Building in Kosovo* (Friedrich Ebert Stiftung: Prishtina, October 2016); Carl T. Dahlman, "Faire frontière dans la paix: le Kosovo et la décentralisation de la concurrenceethno-politique" *L'Espace Politique* [Online], 33 | 2017-3. Në internet: https://journals.openedition.org/espacepolitique/4424?lang=en (shikuar më 28 prill 2023).

[39] **MO** është ngjizur në **Bruksel** më 27 shkurt 2023, kurse në **Ohër** ka marrë bekimin përfundimtar, sepse aty u miratua **Plani i Zbatimit** të saj. Cf. ***Belgrade-Pristina Dialogue: EU Proposal - Agreement on the path to normalisation between Kosovo and Serbia*** (27 shkurt 2023) dhe ***Belgrade-Pristina Dialogue: Implementation Annex to the Agreement on the Path to Normalisation of Relations between Kosovo and Serbia*** (18 mars 2023). Burimi: **EEAS PRESS TEAM** (2023).Tani e tutje, **rruga evropiane** e Kosovës, por edhe e Serbisë, ani se më pak, diktohet nga përmbushja e detyrimeve nga **MO**. Nga të gjitha dispozitat e **MO**, siç mund të shihet, **Serbia** ka vetëm një detyrim për mosveprim, që sanksionohet në nenin 4 të **MO**, dhe konsiston në mospërfaqësimin e Kosovës në sferën ndërkombëtare dhe as në veprim në emër të Kosovës. Detyrim aktiv i **Serbisë** do të mund të cilësohej edhe detyrimi nga pika 4 e **Planit të Zbatimit** të **MO**, sipas të cilit palët detyrohen të përkrahin detyrimet lidhur me gjetjen e personave të zhdukur nga regjimi serb në luftën e vitit 1988-1999 mes **Kosovës**, përkatësisht mes forcave të **Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës** (UÇK) dhe **NATO**-s, në njërën anë, dhe **Serbisë** (Ushtrisë, Policisë dhe paramilitarëve serb), në anën tjetër. Formulimi i kësaj pike, në fakt, e vë Kosovën në pozitë të njëjtë me **Serbisë** sepse

vetëmenaxhimit".[40] Ky definim, që fokusohet në konceptin e "vetëmenaxhimit" të serbëve lokal, ka një dispozitë shtesë, në nenin 7.2, që lidhet me **Kishën Ortodokse Serbe** (KOS) dhe me trashëgiminë fetare dhe kulturore të vendeve serbe.[41] Këto dy risi nuk hasen në asnjë dokument juridik të Kosovës që është prodhuar nga dialogu me Serbinë që nga viti 2011, as në **MA 2013**[42] dhe as në **MA 2015**. Me të parën janë vënë themelet e krijimit të **Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe** (A/BKS), [43] kurse më të dytën, e cila ka karakterin e normës implementuese të **MA 2013**, është operacionalizuar tutje përmbajtja e **A/BKS**.[44] Për implementimin e **MO** përkujdeset vetë BE, e cila, për dallim nga MA 2013 dhe MA 2015, ka krijuar një komitet të përbashkët (neni 10 i **MO** lidhur me pikën 6 të **Planit të Zbatimit** të **MO**). Dy vendet do ta kenë si barometër për rrugëtimin e tyre evropian, nivelin e zbatimit të dispozitave të **MO** dhe **Planit të Zbatimit** (pika e fundit e **Planit të Zbatimit** shprehimisht lidh pranimin në **BE** me nivelin e zbatimit të detyrimeve të **MO** nga palët). **MO** dhe **Plani i Zbatimit** nuk janë marrëveshja e fundit për normalizim të marrëdhënieve mes dy vendeve, aq më pak ndonjë **njohje de jure** ose **njohje de fakto** e Kosovës. Kjo bëhet e qartë nga redaktimi i dispozitës së nenit 6.1 të MO, që përcakton se "[...] Në ndërkohë që kjo marrëveshje paraqet një hap të rëndësishëm në normalizim, dy palët do të vazhdojnë me procesin e rifuqiuzar të dialogut të udhëhequr nga BE-ja, që duhet të çoj

për dy palët vlen detyrimi për mbështetjen e gjetjes së personave të zhdukur, pra **Kosova** e cila nuk ka qenë shtet në kohën e luftës së saj me **Serbinë** (1998-1999) ka marrë detyrim për të zbuluar vendet se ku gjenden personat e zhdukur (sic!).

40 Neni 7.1 i **MO**: "Palët pajtohen për krijimin e aranzhmaneve dhe garancioneve, në pajtim me instrumentet relevante të Këshillit të Evropës dhe duke u bazuar në përvojat ekzistuese evropiane, me qëllim të sigurimit të një niveli të duhur të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë dhe mundësi për shërbime në fushat specifike, përfshirë mundësinë për ndihmë financiare nga Serbia dhe komunikim të drejtpërdrejtë mes komunitetit serb dhe Qeverisë së Kosovës". Në **Planin e Zbatimit**, kjo dispozitë është konkretizuar, duke specifikuar se, për arritjen e këtij objektivi, për themelimin e vetëmenaxhimit për serbët lokal, do të kenë rëndësi parësore marrëveshjet e kaluara të arritura mes palëve, që nënkupton **MA 2013** dhe **MA 2015**, në injorim të tërësishëm të aktgjykimit të **Gjykat**ës Kushtetuese të Kosovës (**GJKRKS**) lidhur me **MA 2015**.

41 Neni 7.2 i **MO**: "Palët do të formalizojnë statusin e Kishës Ortodokse Serbë në Kosovë dhe do të ofrojnë një nivel të lartë të mbrojtjes së vendeve religjioze dhe të trashëgimisë kulturore serbe, në pajtim me modelet ekzistuese evropiane".

42 **Ligji Nr. 04/L-199 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë Ndërkombëtare të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë**. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* nr. 38/17 shtator 2011/Prishtinë.

43 **MA** 2013 ka gjithsej 15 paragrafë, prej të cilëve paragrafët 1 deri në 6 flasin gjerësisht dhe në mënyrë konkrete për themelimin e një asociacioni/bashkësie të komunave me shumicë serbe. Asociacioni/Bashkësia themelohet nëpërmjet Statutit dhe modelohet duke u bazuar në strukturën dhe formën e asociacionit ekzistues të komunave të Kosovës. Në nenin 4 të **MA** 2013, përcaktohet se "[…] Komunat pjesëmarrëse do të kenë të drejtë të bashkëpunojnë në ushtrimin e kompetencave të tyre përmes Asociacionit/Bashkësisë në mënyrë kolektive. Asociacioni/Bashkësia do të ketë mbikëqyrje të plotë mbi fushat e zhvillimit ekonomik, arsimin, shëndetësisë, planifikimit urban dhe rural". Neni 6 i **MA** 2013, ndërkaq, i jep këtij organizmi një "[…] Rol përfaqësues te autoritetet qendrore dhe do të ketë një ulëse në Këshillin Konsultativ të Komuniteteve për këtë qëllim". Për komentet lidhur me këtë, cf. Enver Hasani, "Rasti i Asociacionit serb në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës" E Drejta/Law Viti XLI - Nr. 1-4 (2015), fq. 7-33.

44 **MA** 2015 ka gjithsej 22 paragrafë dhe në tërësi shtjellon dispozitat e **MA** 2013, por duke e cilësuar tani si një asociacion/bashksi që mbron e që promovon interesat e serbëve lokalë, që ka një status juridiko-administrativ on par me personat juridikë nga e drejta publike në Kosovë, me të gjitha pasojat që bart një status i tillë juridiko-kushtetues, përkatësisht që Qeverisë i jep tagrin e dekretimit të Statutit të Asociacionit/Bashkësisë, kurse **GJKRKS** një "juridiksion shtesë" sa i përket kontrollit të kushtetutshmërisë së këtij statuti pasi të jetë draftuar nga komisioni menaxhues dhe pas vërtetimit me dekret qeveritar. Në shikim të parë, duket qartë se **MA** 2015 dukshëm del nga kuadri i përcaktuar i MA 2013, sepse krijon statuse, të drejta dhe detyrime të nivelit lokal, që mund të cenojnë rëndë parimet themelore të sistemit kushtetues kosovar. **MA** 2015 është shpallur jokushtetuese në pjesën dërrmuese. Cf. *Aktgjykim në rastin nr. KO 130/15. Parashtrues: Presidentja e Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore" me frymën e Kushtetutës, me nenin 3.1 [Barazia para Ligjit], me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.* Prishtinë, 23 dhjetor 2015. **Gjykata Kushtetuese e Republikës s**ë **Kosovës**. Nr. ref.:AGJ877/15. Për komentet, cf. Enver Hasani, "Rasti i Asociacionit serb në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës", fq. 7-33.

në një marrëveshje ligjërisht të detyrueshme për normalizim të marrëdhënieve të tyre". Pra as në të ardhmen nuk mendohet për detyrim të palëve për njohje reciproke, qoftë **de jure** ose **de facto**, por vetëm për normalizim të marrëdhënieve mes tyre. Ai normalizim mund të arrihet edhe përmes formave të tjera shtetërore, krahas bashkëpunimit mes dy shteteve sovrane dhe të pavarura. Kjo mbetet të shihet, pra të shihet se çfarë forme shtetërore në fund do të kenë dy shtetet, kur palët të arrijnë normalizimin e plotë të marrëdhënieve mes tyre: a do të jetë forma shtetërore aktuale që kanë palët respektive, apo ndonjë tjetër formë shtetërore që mund të imponohet nga jashtë për palët në rrugëtimin e tyre të **integrimit euro-atlantik**?

Në vijim si më sipër, pyetja që shtrohet është kjo: cili është statusi juridik i MA 2013 dhe MA 2015? Pa asnjë dyshim, ky status duhet vlerësuar në dritën e nenit 10.2 të **MO**, i cili përcakton si vijon: "Palët konfirmojnë detyrimin për të zbatuar të gjitha marrëveshjet e prodhuara nga dialogu i kaluar, të cilat ngelin të vlefshme dhe të detyrueshme". Kjo nënkupton që **institucioni ombrellë i vetëmenaxhimit serb** në Kosovë do të jetë **A/BKS**, që efektivisht, në praktikë, do të ketë karakterin e një **bashkësie territoriale** të komunave me shumicë serbe në Kosovë, përkatësisht të lidhjes së ngushtë territoriale mes komunave ku serbët janë në shumicë në Kosovë. Kjo është arsyeja pse serbët insistojnë që forma e autonomisë së tyre regjionale të ketë emrin "Bashkësi" ("Zajednicë"), jo "Asociacion" ("Asociacija").[45] Një rol të posaçëm në këtë do të ketë **Republika e Serbisë**, e cila, sipas nenit 7.2 të MO ka "[...] mundësi për ndihmë financiare nga Serbia dhe për krijim të kanalit të komunikimit të drejtpërdrejtë të komunitetit serb me Qeverinë e Kosovës". Nëse merret i izoluar, koncepti "vetëmenaxhim" nënkupton autonomi joterritoriale, e cila definohet si e drejtë për të menaxhuar punët vetjake të komunitetit dhe për të pasur rol këshillëdhënës dhe të konsulencës në dobi të komunitetit përkatës që mbrohet me këtë lloj autonomie. Institucionet që implementojnë autonominë joterritoriale ekzistojnë kryesisht në nivel lokal. U mor vesh, ato koncentrohen në vendet ku jetojnë komunitetet pakicë, që shpesh cilësohen si atdheu i tyre, por vetë komunitetet nuk definohen territorialisht. Ato definohen nga populli që përdorë (shfrytëzon) institucionet e autonomisë në fjalë. Këto institucione zakonisht grupohen në një **organizatë ombrellë**, e cila funksionon si **institucion lider i autonomisë joterritoriale**. Autonomitë joterritoriale krijohen për të mbrojtur grupet minoritare etno-kulturore, të shpërndara nëpër popullsinë tjetër të vendit. Meqë anëtarët e këtyre grupeve nuk jetojnë kompakt së bashku, ata nuk mund të kërkojnë të drejta territoriale. Kjo nuk do të thotë se grupet nuk mund të kenë lidhje të ngushtë me territorin e caktuar brenda shtetit, sepse në të shumtën e rasteve ata kanë këtë lidhje të ngushtë. Grupet pakicë shumë lehtë mund të definohen si grupe me identitet përkatës etno-kulturor, lashtësi, religjion, gjuhë ose kulturë. Autonomitë joterritoriale mund të ofrojnë të drejta speciale politike, me qëllim të sigurimit të pjesëmarrjes në vendimmarrje lidhur me çështjet që lidhen me identitetin e grupit minoritar, siç janë kultura dhe arsimi. Kjo është arsyeja pse autonomitë joterritoriale quhet ndryshe edhe **autonomi kulturore**. Kjo nënkupton, pra, që autonomia joterritoriale bazohet në të drejta të autonomisë speciale personale që u ofrohen pjesëtarëve të grupit specifik nacional, etnik, fetar, gjuhësor, autokton (indigjen). Këtu nuk luan rol numri, pakicat nuk kanë nevojë të jenë në pozitë dominante e as në shumicë, përkundër që në praktikë ato janë në pakicë dhe jodominante numerikisht.[46]

Këto shtjellime mbi autonominë joterritoriale janë në vija të përgjithshme, në nivel parimi. Në praktikë, brenda kësaj autonomie janë kristalizuar tri forma standarde: **autonomia tradicionale joterritoriale**, **autonomia administrative joterritoriale** dhe **autonomia funksionale joterritoriale**.[47] Modeli **tradicional i autonomisë joterritoriale** është shumë afër modelit territorial të autonomisë. Zakon-

[45] Ky segment ka nisur që në fillim të bisedave lidhur mes palëve në **Bruksel**, siç e dëshmon vetë ndërmjetësuesja evroipiane e kohës, e cila thotë se serbët në vazhdimësi kanë insistuar që organizimi i ri të quhet "Bashkësi", kurse pala shqiptarë të kundërtën e saj, përkatësisht "Asociacion". Cf. Catherine Ashton, *And Then What?: Inside Stories of 21st-Century Diplomacy* (Elliott & Thompson: London, 2023), fq. 109-145.

[46] Cf. Tove H. Malloy, "Territorial or non-territorial autonomy: The tools for governing diversity". Në Brian C. H. Fong and Atsuko Ichijo, *The Routledge Handbook of Comprative Territorial Autonomies*, fq. 48-66 në fq. 49, 55-56.

[47] Ibid., fq. 58-60.

isht bazohet në marrëveshje të njohura në nivel kushtetues si dhe nga instrumentet juridike primare që formësojnë (kornizojnë) të gjitha sferat relevante të autonomisë. Arsyeja pse kjo emërtohet si ”autonomi tradicionale joterritoriale” ka të bëj me atë se, sikur autonomia terriotriale me të cilën ngjason shumë, krijimi saj kërkon një kuadër të përshkruar mirë dhe gjithëpërfshirës, juridik dhe institucional, si dhe një shkallë të bashkëqeverisjes përmes kompetencave të ndara mes njësive vetëqeverisëse joterritoriale (grupit nacional, etnik, gjuhësor, fetar, indigjen etj) dhe pushtetit qendror shtetëror. Më e rëndësishmja këtu është se kjo autonomi përfaqëson një proces që çon në një marrëveshje, dhe kompetencat e autorizimet publike të njësisë qeverisëse janë qartë të definuara si nga lartë poshtë ashtu edhe nga poshtë lartë.

Kategoria në vijim, **autonomia administrative joterritoriale**, dallon nga e para në atë se, këtu nuk ekziston një akt i vetëm që garanton autonominë, por mund të ketë aspekte të ndryshme të lidhura me autonominë kulturore në kushtetutë dhe në ndonjë akt administrativ të përgjithshëm. Kjo mund të jetë një akt mbi gjuhën ose arsimin. Pra, të drejtat që mbrojnë dhe zbatojnë paradigmën e autonomisë joterritoriale, gjenden të shkapërderdhura nëpër kuadrin ligjor të shtetit si tërësi, zakonisht nëpër dispozita të ligjeve që normojnë sektorë relevantë të administratës publike si tërësi. Me këtë rast, akti i përgjithshëm juridik dhe dispozitat e veçanta juridike, së bashku formojnë një zinxhirë të të drejtave dhe autorizimeve që kanë të bëjnë me përfituesit individual të autonomisë joterritoriale.

Kategoria e tretë dhe e fundit, **autonomia joterritoriale funksionale**, bazohet kryesisht në aktorët nga e drejta private dhe institucionet që ushtrojnë të drejtat e tyre. Kjo përfaqëson aranzhmanet ku oportuniteti dhe pragmatizmi bashkohen për të ofruar menaxhimin lokal të funksioneve relevante. Kjo autonomi mund të mbështetet në garancionet në nivel kushtetues, por për dallim nga dy autonomitë si më sipër këtu nuk ekziston një akt specifik i përgjithshëm ose i veçantë që drejton apo udhëzon mënyrën për zbatimin e saj. Legjislacioni i të drejtës publike që zbaton autonominë joterritoriale funksionale zakonisht është i shkapërderdhur nëpër kuadrin juridike zakonisht si dispozita ligjore publike që normojnë sektorët relevant të administratës publike (nënseksione ose klauzola individuale në ligjet e ndryshme). Në këtë kuptim, kjo autonomi bazohet, në të njëjtën kohë, në një zinxhirë të të drejtave. Për aq sa organizatat implementuese të saj janë të inkorporuar në të drejtën private, atëherë dispozitat e ligjeve publike rregullojnë institucionet, që do të thotë se, për pasojë, autonomia joterritoriale funksionale ofron tërthorazi administratë publike për përfituesit e saj. Kjo nënkupton se kompetencat nuk janë dhënë drejtpërdrejtë por ndahen në mënyrë të tërthortë mes pushtetit dhe njësisë së qeverisjes joterritoriale funksionale.

Nga sa më sipër, qartë shihet se ideja dhe qëllimi i **MO** nuk kufizohet në **vetëmenaxhim**, përkatësisht në **autonomi joterritoriale**, por në kombinim të kësaj autonomie me modelin tradicional të autonomisë joterritoriale me autonominë territoriale klasike, ngjashëm me autonomitë pesë regjionet autonome në **Itali** (Aosta Valley, Friuli-Venezia Giulia, Sardinia, Sicily dhe Trentino Alto Adige/Sudtirol). Me këtë themelohet një regjionalizëm specifik, ku autonomia e regjionit serb ankorohet në veri të Kosovës, por shfrytëzimi dhe përfitues të saj janë krejt serbët e Kosovës. Aspektin territorial ky regjion asimetrik e shpreh edhe në pozitën juridiko-kushtetuese të **KOS** dhe trashëgimisë fetare e kulturore serbe. Në këtë kuptim, **MO** ka cimentuar themelet e një **kushtetute materiale në Kosovë**, që do të ekzistoj paralel dhe në rivalitet me **KKos**, si kushtetutë formale e një shteti sovran dhe të pavarur. Kjo nuk mund të jetë pa efekt të drejtpërdrejtë në formën e Shtetit të Kosovës: lirisht mund të thuhet se vendi po shndërrohet, bazuar në këtë kushtetutë materiale, në një shtet unitar me decentralizim të avancuar, që ka përbrenda një **autonomi territoriale** (KOS), një **autonomi joterritoriale me të drejtë vetëmenaxhimi** (komuniteti serb në Kosovë, pra jo komunitetet tjera joshumicë), që së bashku e kanë të garantuar raportin e rivalitetit me pushtetin qendror në Prishtinë. Kjo është esenca e decentralizimit të Kosovës me një **regjionalizëm asimetrik**: serbët kanë një autonomitet të caktuar dhe shumë të lartë, në ndërkohë që komunitetet tjera vazhdojnë të gëzojnë të drejtat e tyre në bazë të parametrave kushtetuese të autonomisë joterritoriale që sanksionohen në kapitullin e tretë të **KKos**. Arsyeja pse **Kosova** pas **MO** nuk do të mund të quhet **shtet regjional** është se lidhja mes autonomisë serbe, në rend të parë kishtare që lidhet

me **KOS**, por edhe civile, që lidhet me vetëmenaxhimin e komunitetit serb, trashëgiminë dhe kulturën e tyre, dhe pushtetit qendror në Prishtinë është **lidhje asimetrike**. Siç kemi sqaruar më sipër (dhe siç dihet), te shteti regjional, lidhja mes pushtetit në regjione dhe pushtetit qendror është simetrike. Kosova pas **MO** nuk do të mund të quhet as **shtet federal**, nga shkaku se raporti mes pushtetit qendror dhe pushtetit të serbëve lokal, atij shpirtëror dhe civil, nuk do të bazohet në raport hierarkie mes pushtetit qendror dhe institucioneve të dala nga **MO**. Ajo që është e sigurt sot për sot është se Kosova pas **MO**, më nuk mund të konsiderohet një shtet unitar, siç është definuar në nenin 1.1 të **KKos**, për shkak se **organet e pushtetit qendror** nuk do të kenë asnjë ingerencë për kontroll të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së institucioneve të dala nga **MO**, të cilat do të veprojnë në bazë të **parimit të rivalitetit dhe konkurrencës** ndaj pushtetit qendror me mbështetjeje në strukturat normative të Republikës së Serbisë në të gjitha sferat e jetës dhe punës. Çdo mbështetje e strukturave serbe të pushtetit në Kosovë, në infrastrukturën normative të **Shtetit të Kosovës,** nuk do të jetë veçse e përkohshme dhe transitore, deri në bartjen e memories institucionale të krijuar pas 10 qershorit 1999 në organet dhe institucionet e autonomisë serbe të krijuara me **MO** (bartja e dokumentacionit personal që ka të bëj me serbët lokal, e regjistrave civil dhe dokumentacionit tjetër administrativ). Paralel me këtë bartje, pas formimit, të institucioneve dhe organeve të autonomisë serbe, të njëjtat do të prodhojnë dhe veprojnë si një shtet në shtet dhe do të jenë rival të pushtetit qendror në të gjitha gjymtyrët e pushtetit shtetëror. Nga kjo mund të vërehet se me kalimin e kohës, modeli i shtetit të Kosovës i ndërtuar më 17 shkurt 2008, ka pësuar ndryshime radikale. Ngelen të shihen modalitetet e ndryshimit, por tani për tani mund të thuhet, pa asnjë dyshim, se **MO** ka prodhuar një autonomi serbe që ka dy dimensione: dimensionin territorial (sa i përket veçanërisht **KOS**) dhe atë **joterriorial** të menaxhimit (sa i përket aspektit civil të komunitetit serb në Kosovë, përfshirë të drejtat e tyre kulturore dhe trashëgiminë tjetër historike e fetare). Mbetet të shihet gjithashtu edhe statusi i gjyqësorit në veri të Kosovës dhe në pjesët tjera të vendit: sikundër dihet, me **MA 2013** është krijuar një apel i veçantë për **veriun e vendit**, por si pjesë e gjyqësorit të Kosovës, i cili akoma është unik, dhe një standard sipas të cilit lëndët që kanë të bëjnë me serbët në tërë territorin e vendit gjykohen dhe vendosen nga panelet (trupat gjyqësore) me një shumicë serbe.[48] Edhe kjo përbën një shenjë të dallueshme të regjionalizmit asimetrik që po shtrin rrënjë në Kosovë, si rezultat i kushtetutës materiale që u cimentua me **MO** dhe **Planin e Zbatimit**.

6.2. Shqipëria

Pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912, menjëherë është shtruar çështja e formës që do të ketë shteti shqiptar. **Ismail Qemajli** (1884-1919), njeriu që lexoj **Deklaratën e Pavarësisë së Shtetit shqiptar**, kishte përfaqësues njëri prej dy modeleve të ndërtimit të shtetit të ri, modelin një shteti shqiptar të ndarë në kantone, sipas modelit zviceran.[49] Shikuar nga perspektiva e sotme, një shtet i regjionalizuar pashmangësisht do të kishte çuar në shprishjen e Shtetit shqiptar, marrë parasysh ndarjet e forta fisnore, regjionale dhe fetare që kanë ekzistuar në këtë kohë dhe përgjatë tërë sundimit otoman. Në fund, megjithatë, ka dominuar pikëpamja për Shqipërinë si një shtet unitar, me një qendër vendosjeje politike ku pushteti normativ nuk ndahet me periferinë dhe në rrafshin hierarkik. Pas mbarimit të **Luftës së Parë Botërore** e deri me sot asnjëherë nuk ka pasur propozime ose përpjekje serioze për regjionalizim të Shqipërisë, aq më pak për federalizim të saj ose për krijimin e autonomive politike territoriale si forma të theksuara të decentralizimit brenda shtetit unitar.[50] Kjo nënkupton që diskutimi ynë për formën e shtetit shqiptar ka të bëj vetëm me ndarjen vertikale të pushtetit të një shteti unitar. Sikundër u sqarua më sipër, pushteti normativ ndahet sipas **modelit unitar**, në të cilin ka vetëm një qendër të vendimeve

[48] Për historikun e këtij fragmentimi të gjyqësorit kosovar përgjatë vijave nacionale dhe etnike, në favor të serbëve lokal, cf. më shumë në librin e ndërmjetësues ndërkombëtare në vitin 2013, Catherine Ashton, *And Then What?: Inside Stories of 21st-Century Diplomacy*, fq. 109-145.

[49] Aureala Anastasi*, Historia e të drejtës kushtetuese në Shqipëri* ("Dajti 2000": Tiranë, 2018), fq. 21.

[50] Për zhvillimin kushtetues dhe politik të shtetit shqiptar nga shpallja e pavarësisë e deri më sot, cf. më shumë në Aureala Anastasi*, Historia e të drejtës kushtetuese në Shqipëri* (për krejt periudhën deri më sot); Për periudhën mes dy luftërave botërore dhe pozitën juridiko-kushtetuese të Shqipërisë, cf. trajtimin e shkëlqyer nga Ksenofon Kristafi, *Organizimi politik në Shqipëri* (UET Press: Tiranë, 2014), fq. 71-120; Për këtë periudhë, cf. edhe autorët Afrim Krasniqi, *Sistemet politike në Shqipëri: 1912-208* (UFO Press: Tiranë, 2009), fq. 15-170 dhe Aleks Luarasi, *Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri* (MALUKA: Tiranë, 2018), krerët XII-XV.

politike, dhe **modelit pluralist**, në të cilin pushteti qendror e ndan pushtetin e tij normativ me autoritetet vendore. Në përsiatjet lidhur me format me të cilat realizohen këto modele, modeli kushtetues shqiptar ndërfutet në **shtet unitare të decentralizuara**, të sqaruara më sipër në këtë pjesë, që realizojnë një ndarje më pak të theksuar të pushtetit normativ midis pushtetit shtetëror në nivel qendror dhe kolektiviteteve vendore. Në raport me dy format tjera shtetërore, përkatësisht në raport me shtetet federale dhe shtetet regjionale, që gjithashtu u sqaruan më sipër, **shtetet unitare të decentralizuara** disponojnë një autonomi normative të kufizuar dhe të kushtëzuar nga parimi i unitetit të pushtetit. E thënë me fjalë të tjera, Shteti shqiptar është një **shtet unitar i decentralizuar**, me dy nivele pushteti: pushteti qendror dhe pushteti i bashkive/komunave. Cilësia e përbashkët e këtij modeli, që është ruajtur gjeri në ditët e sotme, është se ky shtet ka qenë unitar dhe i till ë ka ngelur edhe sot, më autonomi (decentralizim) të moderuar të pushtetit shtetëror.[51] Këtë e diskutojmë te seksioni mbi **vetëqeverisjen vendore** në shtetin shqiptar.

6.3. Maqedonia e Veriut

Njëjtë si vendet tjera fqinje me Kosovën, në **Maqedoninë e Veriut** nuk ekziston një nivel i ndërmjetëm i pushtetit, qoftë në formë të regjionit ose të autonomisë politike. Kushtetuta e **Maqedonisë së Veriut** e vitit 1991 (KMVe), aktualisht në fuqi pas shumë ndryshimeve dhe plotësimeve, bën fjalë vetëm për vetëadministrimin lokal dhe nuk njeh forma të tjera të decentralizimit, komuna shfaqet njësi themelore. **KMVe** nuk lejon mundësinë e formimit të formave të tjera të decentralizimit, përveç rastit të qytetit të **Shkupit**, pra nuk përcakton asnjë autorizim për formim të **regjioneve** (simetrike ose asimetrike) ose **autonomive politike** (territoriale ose joterritoriale). Nivelin e qeverisjes lokale në këtë vend i diskutojmë më poshtë.

6.4. Mali i Zi

Mali i Zi nuk dallon në aspektin kushtetues nga vendet tjera përreth sa i takon çështjes së regjionalizimit. Edhe këtu regjionalizimi, për aq sa ekziston, ka kuptimin e regjionalizimit zhvillimor, pra jopolitik, që nuk ka asnjë subjektivitet juridik dhe organe të përfaqësimit politik. Kjo është krejt e natyrshme meqë **Kushtetuta e Malit të Zi** e vitit 2007 (KMZi), aktualisht në fuqi, askund nuk flet për forma të tjera të pushtetit politik, pos të atij qendror dhe të pushtetit në nivel vendor. Në fakt, në nenin 22 të KMZi, garantohet e drejta e vetëqeverisjes lokale në mënyrë shprehimore. Në nenet 113-117 të **KMZi**, komuna përcaktohet si njësi themelore ku realizohet kjo e drejtë kushtetuese.

6.5. Serbia

Serbia është **shtet i decentralizuar** i formës unitare të rregullimit shtetëror. Decentralizimi në Serbi shfaqet në pozitën juridiko-kushtetuese të njësive të **vetëqeverisjes lokale**, si niveli më i ulët i pushtetit politik, dhe **krahinave autonome**, si nivel i ndërmjetëm i pushtetit politik. Nga vitit 200 e këndej, në Serbi ka nisur një proces i decentralizimit, përmes një ligji omnibus dhe më pas, në vitin 2009, me statutin e ri të Krahinës së Vojvodinës. Në këtë kohë ka pasur edhe përpjekje për regjionalizim, por kryesisht në kuptimin zhvillimor. Kjo vërehet edhe nga vetë titulli i një ligji të vitit 2009, që ka pasur të bëjë me zhvillimin regjional, pra jo me dimensionet politike dhe të përfaqësimit. Ky ligj ka krijuar regjionet zhvillimore, fillimisht shtatë e më pas pesë. Këto regjione janë tërësi statistikore funksionale, nuk kanë subjektivitet juridik dhe nuk janë njësi administrativo-territoriale. Për krijimin e konceptit tjetër të regjionalizimit, që do të nënkuptonte regjionin si njësi politike, paraprakisht duhet të ekzistoj një bazë kushtetuese. Kjo për faktin se **Kushtetuta e Serbisë** e vitit 2006, aktualisht në fuqi (KSerb), njeh vetëm dy format e sipërcekura të decentralizimit: njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe krahinat autonome. **KSerb** parashikon se për formimin e krahinave të reja autonome, si njësi të decentralizimit politik, duhen ndjekur procedurat juridiko-kushtetuese. Nivelet tjera të regjionalizimit dhe të decentralizimit politik në nivel të mesëm të pushtetit politik nuk përmenden në **KSerb**.

[51] Luan Omari, Aurela Anastasi, *E drejta kushtetuese* (“Dajti 2000”: Tiranë, 2010), fq. 359-360; Luan Omari, Aurela Anastasi, *E drejta kushtetuese* (“Dajti 2000”: Tiranë, 2017), fq. 325-326.

7. Autonomia territoriale

7.1. Vështrim i përgjithshëm

Koncepti i autonomisë territoriale, si **njësi politike në të cilën qytetarët rregullojnë marrëdhëniet shoqërore me ligje që vetë i krijojnë**, ka qenë i zbatuar që në qytet-shtetet e kohës së Greqisë antike. Poliset greke kanë qenë njësi autonome në kuptim të asaj që ato nuk kanë zbatuar të drejtën e huaj, kanë krijuar të tyren, si pjesë e "vetëdefinimit të komunitetit politik të qytet-shtetit grek".[52] Me kalimin e kohës, koncepti i autonomisë ka kaluar nëpër rrugë të ndryshme të përpunimit, me një botëkuptim të ndryshëm lidhur me atë se çfarë nënkuptohet me këtë term, me kohëzgjatje të ndryshme të autonomive në praktikë, me shuarjen e saj ose kalimin në një formë tjetër të bashkësisë politike. Para autonomive të sotme territoriale, në të kaluarën kanë ekzistuar pararendësit e tyre në perandoritë e shek. XIX. Autonomitë e tilla, me kalimin e kohës janë kthyer në pjesë integrale e shteteve ose kanë kaluar në stadin e shteteve sovrane dhe të pavarura, siç është rasti, ta zëmë, me **Perandorinë Britanike** (Afrika e Jugut, Australia, Shteti i Lirë i Irlandës, Kanadaja, Zelanda e Re), **Perandorinë Otomane** (Bosnjë-Hercegovina, Bullgaria, Egjipti, Rumelia Lindore, Serbia, Vllahia-Moldavia), **Perandorinë Ruse** (Principata e Madhe e Finlandës ka gëzuar një autonomi të madhe përgjatë tërë shekullit, deri në vitin 1809).

Në aspektin etimologjik, fjala **autonomi** përbëhet nga fjalët greke "autos", që d.m.th. vet, dhe fjalës "nomos", që d.m.th., rregull. Në aspektin përmbajtësor, ndërkaq, autonomia nënkupton atë nivel të pushtetit në të cilin krijohen ligje. Kjo e bën qartë të dallueshëm si kuptim përmbajtësor nga vetëqeverisja lokale, e cila nuk ka autorizim për nxjerrje të ligjeve. Në aspektin teorik dhe praktik, më i vështirë është dallimi mes njësisë së autonomisë territoriale dhe njësisë federale, e cila gjithashtu nxjerr ligje. Dallimi fillestar mes tyre konsiston në atë se territori i autonomisë është pjesë e shtetit të thjeshtë (jo të përbërë), kurse njësitë federale janë pjesë e shtetit federal. Dallimi më i madh mes tyre qëndron në faktin se **njësia federale ka të drejtë të nxjerr ligje për shkak të autorizimit burimor**, i cili rrjedh nga prezumimi i juridiksionit dhe kompetencës në favor të njësisë federale, jo në favor të shtetit. Autonomia territoriale, ndërkaq, nuk e ka të drejtën e nxjerrjes së ligjeve si kompetencë të saj burimore, për shkak se ajo e drejtë rrjedh nga juridiksioni dhe kompetenca ligjvënëse e shtetit ku gjendet autonomia në fjalë. Kjo është arsyeja pse shteti ka të drejtën e kontrollit kushtetues të ligjeve që nxjerr njësia e autonomisë territoriale, të drejtën e vlerësimit të ligjshmërisë së akteve nënligjore që nxirren me qëllim të zbatimit të ligjeve të shtetit, dhe mund të ketë edhe të drejtën e kontrollit të oportunitetit të dispozitave që i ka nxjerrë vetë autonomia territoriale (nëse nxjerrja e tyre ka qenë me vend ose jo).

Në shtete krijohen njësi të autonomisë politiko-territoriale (autonomia territoriale) për shkak të **cilësive të posaçme të territoreve të caktuara**, zakonisht nga shkaku se ato janë aq të mëdha sa të kërkojnë shkallë më të madhe të autonomitetit politik, krahasuar me vetëqeverisjen lokale. Në të njëjtën kohë, cilësitë në fjalë, por edhe kërkesat për pavarësi të territorit, nuk janë aq të forta dhe me ngulm sa të shtrojnë nevojën e ndryshimit të cilësisë së rregullimit shtetëror, përkatësisht që shteti të federalizohet. Cilësitë e territoreve të caktuara, përveç madhësisë, lidhen edhe me **cilësitë tjera gjeografike ose ekonomike**, siç janë: një klimë e veçantë, ujdhesë, tokë bujqësore, zonë malore etj. **Kërkesat politike për autonomi**, ndërkaq, rrjedhin nga shkaqet që ekskluzivisht lidhen me popullsinë e territorit. Ato shkaqe kanë të bëjnë me cilësitë për sa vijon: dallimet nacionale, fetare, racore, gjuhësore, kulturore, dhe, së fundi, shkaqet që lidhen me historinë politike të qytetarëve të regjioneve të caktuara brenda shtetit. Kanë qenë shkaqet kryesisht etniko-gjuhësore arsyeja për themelimin e **Katalonisë** (Spanja), gjeografiko-terriorriale sa i përket ishujve **Azores** në Portugali (janë 1,600 km në perëndim të **Portugalisë** kontinentale), historiko-kulturor dhe fetar (**Mali Atos** në Greqi), etniko-fetar (Qarkut Autonom Hebraik në lindjen e

[52] Edward M. Harris, "Antigone the Lawyer, or the Ambiguities of *Nomos*". Në Edward Harris and Lene Rubinstein (eds), *The Law and Courts in Ancient Greece* (Duckworth: London, 2004), fq. 19, cituar sipas Christopher May, "The Rule of Law: Athenian Antecedents to Contemporary Debates" Vol. 4 Issue 2 (2012) 4 *Hague Journal on the Rule of Law* (September 2012), fq. 235-251, në fq. 240.

largët të Federatës së Rusisë). Përkundër që këto arsye, në një masë të madhe, mund të gjenden në një numër të madh të shteteve të sotme, autonomia territoriale akoma ngelet krijesë kryesisht evropiane që ekziston në dhjetëra shtete evropiane. Në mënyrë sporadike, autonomia territoriale lajmërohet edhe në disa shtete unitare jashtë **Evropës** (Indonezia, Iraku, Kina, Kili, Kongo, Nikaragua).

Forma e autonomisë që nuk lidhet në mënyrë parësore me territorin është **autonomia personale**. Te ky lloj i autonomisë, që ndryshe njihet edhe si **autonomia joterritoriale** (për të cilën folëm më sipër në kontekstin e regjionalizimit asimetrik të Kosovës), individët nga grupet e caktuara etnike, fetare, gjuhësore dhe grupi tjetër gëzojnë të drejta të veçanta politike dhe të drejta të tjera, pa marrë parasysh territorin në të cilin jetojnë. Tërësia e të drejtave lidhur me cilësitë e caktuara të individëve, në çka nuk ndikon vendi i banimit dhe qëndrimit të tyre, përbën esencën e **autonomisë personale**. Në këtë mënyrë, pjesëtarët e **autonomisë personale** mund të gëzojnë disa të drejta politike, siç janë: e drejta e zgjedhjes së përfaqësuesve të tyre në organin përfaqësues minoritar; e drejta e praktikimit dhe kultivimit të fesë; e drejta e organizimit të tubimeve fetare, shkollave, universiteteve; e drejta e promovimit dhe ruajtjes së kulturës së tyre dhe kështu me radhë.

Përvoja tregon se edhe atëherë kur ekzistojnë arsyet e mira për themelim të **autonomisë territoriale**, jo me shumë vullnet shtetet pranojnë një gjë të tillë. Në vend të kësaj, shtetet iu janë qasur më shumë formave të buta të përmbajtjeve të autonomisë, të cilat nuk përfshijnë vendimmarrjen politike. Në këtë mënyrë, dallohen **autonomitë kulturore**, **institucionale** dhe **ekonomike**. Përmbajtja e formave të këtyre autonomive përcaktohet me aktet juridike të organeve qendrore, si dhe me akte autonome, që nuk përfshijnë të drejta politike. **Autonomia kulturore** është forma më e butë e autonomisë e zgjidhjes së kërkesave për autonomi politike të pjesëtarëve të kombit pakicë, grupit etnik ose fetar. Me anë të autonomisë kulturore, përmes ligjit që e drafton dhe miraton pushteti qendror, pakicës së caktuar i garantohen të drejtat kulturore në territorin ku jeton, siç janë: e drejta për themelim të institucioneve kulturore dhe arsimore, përdorim zyrtar të gjuhës, liria e medies. Për nga përmbajtja, **autonomia personale** mund të jetë **autonomi kulturore**. As **autonomia institucionale** nuk përfaqëson formë të autonomisë politike. Atë e gëzojnë disa institucione dhe anëtarët e tyre. Si shembull i kësaj zakonisht merret autonomia e universiteteve, të punësuarit dhe studentët gëzojnë lirinë e organizimit institucional, arsimimit, hulumtimit shkencor dhe kritikës. Këtë autonomi e gëzojnë edhe institucionet e tjera të arsimit, shëndetësisë, shoqatat të ndryshme dhe kështu me radhë. Së fundi, **autonomia ekonomike** lidhet me konceptin e regjioneve ekonomike si tërësi ekonomike, në të cilat zhvillohet një politike e caktuar ekonomike, e përshtatur ndaj kushteve të ekonomizimit në atë regjion zhvillimor.

Në disa shtete ekzistojnë **format e veçanta të autonomisë**, që formohen në territore të caktuara për arsye racore, nacionale ose historike, mirëpo nga përmbajtja e tyre janë autonomi kulturore dhe ekonomike. Ato janë autonomi të veçanta, siç janë ta zëmë rezervatet për **popullsinë autoktone** (indigjene) në Australi, Brazil, Kanada, SHBA, Zelandë të Re etj., në të cilat pushteti qendror ua garanton të drejtën për të jetuar sipas traditës së tyre, duke i liruar nga pagesa e tatimeve, taksave dhe detyrimeve të tjera kushtetuese. Ky lloj autonomie sanksionohet edhe në dokumente të shumta ndërkombëtare dhe mund të thuhet se mbrohet nga rendi juridik-ndërkombëtar si një formë e vetëvendosjes.[53]

[53] Regjimet autonome në të **drejtën ndërkombëtare** janë mjete për të ofruar liri më të mëdha për popujt autokton. Këto regjime autonome të themeluara brenda shteteve shërbejnë për të krijuar hapësirë për vetëqeverisje dhe ndihmojnë e lehtësojnë **popujt indigjenë** për të ndjekur rrugën e tyre të zhvillimit. Në këto raste të autonomisë ekzistojnë probleme e pengesa, siç janë tensioni mes të drejtave individuale dhe kolektive, definimi i llojit ideal të autonomisë që nuk del i saktë në praktikë dhe, së fundi, mungesa e vullnetit për implementim. Cf. më shumë në Christina Binder and Constanze, "A capability perspective of indigenous autonomy". *Oxford Development Studies* Vol. 44 Issue 3 (2016), fq. 297-314 (diskuton rastet e Kolumbisë, Meksikos dhe Nikaraguas); Për kontekstin **latino-amerikan** të autonomisë së **popujve indigjenë**, cf. më shumë në Víctor Bretón, Miguel González, Blanca Rubio, Leandro Vergara-Camus, "Peasant and indigenous autonomy before and after the pink tide in Latin America". *Journal of Agrarian Change* (Special Issue) Vol. 22 Issue 3 (July 2022), fq. 547-575.

7.2. Cilësitë juridike të autonomisë territoriale

Autonomia territoriale është kategori kushtetuese dhe ligjore. E tillë mund të jetë edhe **autonomia joterritoriale**, por vetëm në disa format e saj të manifestimit, siç e kemi diskutuar më sipër, për aq sa kjo ka të bëj me **regjionalizëm politik** brenda shtetit (pra kur regjionet e caktuara, në trajtë **asimetrike** ose **simetrike**, ose dyja së bashku, përfaqësojnë nivelin e ndërmjetëm të pushtetit; Italia dhe Spanja, janë shembuj tipik të kësaj forme shtetërore). Si **kategori kushtetuese**, një gjë e tillë nënkupton që kushtetuta e shtetit parashikon ekzistimin e autonomisë territoriale dhe rregullon (normon) bazat (themelet) e pozitës së saj. Thënë me fjalë të tjera, me kushtetutë definohet autonomia territoriale, konstatohet ekzistimi i saj, gjë që është konfirmim i themelimit të autonomisë me aktin më të lartë juridik në vend, eventualisht parashihet mundësia e krijimit të autonomive të tjera territoriale, si dhe normohet vetë baza e organizimit dhe funksionimit të pushtetit autonom, përfshirë fuqinë juridike të akteve juridike të përgjithshme që nxjerrin organet e autonomisë territoriale. Kushtetuta normon edhe juridiksionin e autonomisë territoriale, në një mënyrë të përgjithshme, si çështje me rëndësi të përgjithshme në fushat shoqërore të numëruara taksativisht. Është **kategori ligjore**, sepse me ligj në mënyrë të detajuar rregullohen çështjet e organizimit të pushtetit të saj, juridiksioni dhe kompetenca, të cilat, si rregull, përcaktohen sipas sistemit të numërimit taksativ. Kjo nënkupton se ekziston prezumimi i juridiksionit dhe kompetencës në favor të shtetit. U mor vesh, nga ky rregull ekzistojnë përjashtime, siç janë: rasti i autonomisë së **Irlandës Veriore**, e cila posedon prezumimin e juridiksionit për nxjerrjen e ligjeve që kanë të bëjnë me paqen, rendin dhe qeverisjen (drejtimin) e mirë; rasti i autonomive të **Madeira**-s dhe **Azores**-it në **Portugali**, të cilat kanë të drejtë të normojnë çështjet që shprehimisht nuk janë lënë në juridiksion të pushtetit sovran; rasti i ishujve **Aland** në Finlandë, të cilat nxjerrin ligje me kusht që ato të jenë në pajtim me ligjet e shtetit.

Vartësia ndaj pushtetit shtetëror dhe ligjeve të tij flet mjaftueshëm për statusin juridiko-kushtetues të autonomisë territoriale dhe për fuqinë juridike të dispozitave të saj. Sa i përket **statusit juridiko-kushtetues**, autonomia territoriale varet nga vullneti politik i pushtetit qendror. Shteti mundet në mënyrë të njëanshme, me vendimin e vet, të abrogoj autonominë territoriale, në po atë mënyrë siç edhe e ka themeluar. Dallimet mes vendeve që shfaqen këtu kanë të bëjnë me ndërlikushmërinë e vogël ose të madhe të procedurës së themelimit dhe heqjes së saj. Përcaktohet që abrogimi mund të bëhet përmes procedurës juridiko-kushtetuese, sepse me kushtetutë janë themeluar, ose në procedurë ku shprehen edhe qytetarët përmes referendumit. Nëse është i detyrueshëm, atëherë **referendumi** parashihet si njëra prej fazave të procedurës te çështja e **ndryshimit të territorit të autonomisë**, zvogëlimi ose zmadhimi i tij, ku vullnetin e shprehin qytetarët e asaj autonomie territori i së cilës është objekt ndryshimi. Te abrogimi (heqja) ose themelimi i autonomisë territoriale deklarohen krejt qytetarët e shtetit, sepse këtu bëhet fjalë për ndryshimin e rregullimit shtetëror. Sa i përket **hierarkisë së akteve juridike**, ndërkaq, së pari duhet vënë në dukje se në shtetet unitare me autonomi territoriale dhe vetëqeverisje lokale të zhvilluar, shikuar në mënyrë të rreptë, nuk ekziston vetëm një rend juridik. Në këto shtete, në nivelin e mesëm dhe lokal të pushtetit, krijohen sisteme specifike juridike që përbëhen nga dispozitat e autonomisë territoriale dhe aktet që nxjerr vetëqeverisja lokale.

Rendin juridik të autonomisë e përbën **statuti**, një emër i përbashkët për aktin më të lartë juridik të autonomisë, ligji (në rastet kur autonomia ka juridiksion ligjvënës) dhe dispozitat nënligjore. Në aspektin juridik-krahasimor, aktet më të larta të autonomive territoriale kanë fuqi të ndryshme juridike. Në disa vende statuti është me fuqi më të lartë juridike se ligji i zakonshëm por më të ulët se kushtetuta (gjashtë regjionet me status të posaçëm në **Itali**, tri bashkësitë autonome me status të posaçëm në **Spanjë**, ishujt **Aland** në **Finlandë**). Në vendet tjera ai ka fuqinë juridike të ligjit të zakonshëm (ishujt **Faroe** në **Danimarkë**, **Madeira** në **Portugali**, 14 bashkësitë autonome me status të zakonshëm në **Spanjë**). Së fundi, ai mund të ketë fuqinë juridike të aktit të zakonshëm nënligjor (qytetet autonome në **Spanjë**, **Vojvodina** në Serbi). Kategorizimi sipas fuqisë juridike i aktit më të lartë të **autonomisë territoriale**, megjithatë nuk është çdo herë i sigurt, nga shkaku se, marrë parasysh procedurën e miratimit të tij, mund të bëhet

fjalë për një dispozitë me natyrë dhe fuqi specifike juridike. Një rast i tillë ekziston kur në procedurën e miratimit të statutit marrin pjesë subjektet siç janë: trupi i veçantë i formuar për këtë qëllim dhe qytetarët në referendum (**Spanja**), apo së bashku parlamenti i shtetit dhe i autonomisë territoriale (**Finlanda**, **Ukraina** etj.). Për këtë shkak dhe me qëllim të shmangies së kontesteve kushtetuese, është e dobishme që me kushtetutë të përcaktohet **hierarkia e akteve juridike në krejt shtetin**. Sa i përket akteve të tjera juridike që i sjellin organet e autonomisë territoriale, ligjeve dhe akteve nënligjore (vendimeve, udhëzimeve, urdhëresave, rregulloreve), ato duhet të jenë në pajtim me kushtetutën dhe ligjet e shtetit.

Për dallim nga njësia federale, autonomia territoriale nuk ka veçoritë e shtetit, apo i ka në një masë shumë më të vogël dhe vetëm sa i përket ndonjërit prej elementeve të tij individuale. Kështu, ta zëmë, qytetarët e njësisë së autonomisë territoriale kanë **shtetësinë e shtetit**, jo të autonomisë. Autonomia territoriale nuk i ka të gjitha **simbolet e shtetit**, siç janë: stema, flamuri dhe himni. Në disa vende, autonomitë kanë simbolet e tyre, zakonisht stemën dhe flamurin (Danimarka, Finlanda, Serbia, Spanja etj). Gjithashtu, në vijim të këtyre dallimeve, autonomia territoriale, për dallim nga njësia federale, **nuk është e përfaqësuar në mënyrë të veçantë në parlamentin nacional**. Kjo rregull, në praktikë, gjatë devolucionit dhe zhvillimit të autonomive është anashkaluar në mënyrë të tërthortë. Autonomitë territoriale ”fitojnë” vendet e tyre në parlament, jo në mënyrë të njëjtë siç u takon njësive federale në **dhomën e sipërme**, por përmes **njësive zgjedhore** që gjenden në territorin e autonomisë territoriale (**Britania e Madhe**, **Danimarka**, **Finlanda**, **Italia**, **Spanja**). Sërish, për dallim nga njësia federale që nuk ka përfaqësues të pushtetit qendror brenda organeve të veta, në disa shtete organizimi i pushtetit në autonominë territoriale e përbën edhe një organ i posaçëm i pushtetit qendror (**Britania e Madhe**, **Finlanda**, **Italia**, **Portugalia**, **Spanja**). Ai organ qendror që operon brenda organizimit të pushtetit në autonominë territoriale, zakonisht ka të drejtën e mbikëqyrjes dhe kontrollit, pa funksione operative (ekzekutive). Në këtë kontekst, ekzistojnë shtete në të cilat pushteti qendror në mënyrë të detajuar, jo vetëm në parim dhe themel, rregullon organizimin dhe funksionimin e pushtetit dhe autonominë territoriale.

Lidhur me organizimin e pushtetit, juridiksionit, kompetencës dhe mbrojtjes juridike të **autonomisë territoriale** vlen tërë ajo që u tha më sipër për **autonomitë regjionale**.

8. Autonomia territoriale: përfundimet

Autonomitë territoriale formohen në shtetet unitare për arsye të njëjta që formohen njësitë federale në federata. Në mesin e këtyre arsyeve dominojnë ata etnik, historik dhe gjeografik. Përjashtimisht, autonomitë territoriale ekzistojnë edhe në federata (**Federata Rusisë**, **India**). Cilësia themelore e shteteve me autonomi territoriale konsiston në atë se ato **janë asimetrike në aspektin territorial.** Kjo nënkupton se, autonomitë nuk ekzistojnë në krejt territorin e shtetit, por vetëm në një ose disa pjesë të tij. Përjashtim nga kjo cilësi përbëjnë rastet e autonomive në **Itali** dhe **Spanjë** (të cilat hyjnë në kategorinë e **shteteve regjionale**). Asimetria në organizimin territorial hap çështjen e barazisë së qytetarëve, sepse më shumë të drejta se të tjerët gëzojnë qytetarët që jetojnë në kuadër të autonomisë territoriale. Përveç cilësisë si më sipër, autonomitë territoriale kanë edhe disa karakteristika të tjera më përmbajtësor, të cilat i diskutojmë në vijim.

Autonomia territoriale, në rend të parë, nënkupton **vendimmarrje politike,** brenda së cilës hyn edhe **nxjerrja e ligjeve**. Në aspektin teorik, autonomitë e pastra territoriale me vetëqeverisje politike, nuk mund të ekzistojnë pa kompetencën në ligjvënie. Format ideale teorike, megjithatë, vështirë hasen në realitetin jetësor. Ato që ekzistojnë, sipas karakteristikave të tyre, dallojnë nga format ideale kryesisht në **dy drejtime**. Një drejtim shkon kah ngjashmëria me njësitë federale, gjë që nënkupton autorizime për më shumë pavarësi, më shumë fusha që normohen me ligje autonome në mënyrë të pavarur, përfshirë edhe të drejtën për të pasur kushtetutë vetjake (ish-**Jugosllavia**, ish-**Bashkimi Sovjetik**). Drejtimi i dytë shkon kah përafrimi i autonomisë me qeverisjen vendore, që nënkupton mbikëqyrje të plotë nga organet qendrore, prani të organeve qendrore brenda autonomive territoriale dhe, së fundi, mungesë të kompetencës ligjvënëse të autonomisë territoriale.

Një karakteristikë tjetër e rëndësishme e autonomisë territoriale është se ajo ka formë të njëjtë të qeverisjes, të rregullimit shtetëror dhe të pushtetit shtetëror, sikur shteti pjesë e të cilit është. Sistemi parlamentar që ka shteti, megjithatë, në autonomitë territoriale mund të jetë më i ndryshëm ashtu që vihet theksi te pozita e organit përfaqësues, duke bërë që sistemi i pushtetit të ngjasoj dhe përafrohet shumë me **sistemin e kuvendeve**. Kjo assesi nuk nënkupton se autonomia territoriale merr pjesë në formimin e vullnetit politik në shtet. Ajo nuk merr pjesë në këtë formim të vullnetit të përgjithshëm politik në shtet, sepse nuk ka përfaqësuesit e saj në pushtetin ekzekutiv. Kjo përbën një karakteristikë tjetër të rëndësishme dhe me peshë të autonomisë territoriale. Përveç pushtetit ekzekutiv, kjo përfshinë edhe organin nacional ligjvënës dhe kushtetutëbërës: në shtetet me **autonomi territoriale asimetrike** nuk ka përfaqësues të autonomisë as në organin nacional përfaqësues (përjashtimisht ka qenë në ish-**Jugosllavi** dhe ish-**Bashkimin Sovjetik**). Në shtet me **autonomi simetrike** në tërë territorin shtetëror (**Italia**, **Spanja**) ekzistojnë të zgjedhurit e autonomive territoriale që janë përfaqësues të tyre në **dhomën e sipërme** të parlamentit.

Autonomia territoriale gëzon **pavarësi të kombinuar** me të drejtat e pushtetit qendror, i cili garanton, kontrollon dhe ngushton vetëqeverisjen e saj. Autonomitë gëzojnë pavarësi të pjesshme, një pjesë e të ardhurave barten në shtet kurse një pjesë e marrin nga pushteti qendror. Shteti mban për vete **të drejtën e mbikëqyrjes** ndaj autonomisë territoriale dhe për joligjshmërinë e konstatuar mund të ndërmarr sanksione, siç janë: shpërndarjen e organit përfaqësues të autonomisë, suspendimi ose abrogimi i akteve juridike dhe politike. Në të njëjtën kohë, shteti përcakton mekanizimin për mbrojtjen juridiko-kushtetuese të statusit dhe të drejtave të autonomisë territoriale nga i njëjti pushtet qendror, pra mbrojtje nga vetvetja, duke i garantuar asaj të drejtën e përdorimit të instrumenteve juridike pranë gjykatës kushtetuese ose gjykatave të rregullta.

Natyra e autonomisë territoriale është e atillë që ajo paraqet **një zgjidhje jokomplete politike (zgjidhje e papërfunduar)** në rregullimin e brendshëm të shtetit unitar. Ajo paraqitet si një lloj sigurese përmes së cilës zbuten dhe heshtën tensionet dhe konfliktet në shtet dhe zvogëlohen dallimet politike. Gjendja jo komplete (e papërfunduar) e autonomisë territoriale lejon mundësinë që e njëjta të abrogohet (hiqet) (autonomia hungareze në **Rumani**) ose të ngrihet në rangun e njësisë federale (**Belgjika**). Për kohën sa ekziston, në marrëdhënien mes saj dhe pushtetit qendror, rrethanat politike ndryshojnë në mënyrë ciklike, njëra forcohet e tjetra dobësohet dhe anasjelltas.

9. Autonomia territoriale në Kosovë dhe vendet fqinje

9.1. Kosova

Për Kosovën në këtë seksion flasim si për autonomi politiko-territoriale që ka ekzistuar nën ish-Jugosllavi. Trajtimi ynë për këtë pjesë pashmangësish lidhet me librin e doajenit të së drejtës kushtetuese të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, profesorit të ndjerë **Kurtesh Salihut**.[54] Ky libër, më mirë se askush tjetër, shpjegon lindjen dhe zhvillimin e autonomitetit të **Kosovës** në ish-Jugosllavi, por me premisa të theksuara ideologjike, të cilat ne i vejmë në dukje. Premisë bazë ë lindjes së këtij autonomiteti ka qenë, sipas shpjegimeve të asaj kohe, **Lufta Nacional Çlirimtare** (LNÇ) e shqiptarëve nën ish-Jugosllavi.[55] U mor vesh, kjo premisë ka qenë dhe është ideologjike dhe fare nuk ka të bëj me realitetin mbi të cilin ka qëndruar autonomiteti i Kosovës në atë shtet. Këtë dimension, askush më mirë nuk e ka shpjeguar se **Millovan Gjilas** (Milovan Djilas: 1911-1995), disidenti më i njohur i krejt lindjes ish-komuniste dhe nënkryetar i Jugosllavisë komuniste në vitet e para pas **Luftës së Dytë Botërore**, bashkëpunëtori më i ngushtë i Titos (Josip Broz Tito: 1892-1980), kur ka treguar lindjen e **Republikës së Malit të Zi**. Malazezët kanë qenë ndër kuadrot më pro-komuniste në Jugosllavi dhe përtej, ndër luftëtarët më të devotshëm kundër nazi-fashizmit, që nga ditët e para të nisjes së **Luftës së Dytë Botërore**. Kjo, megjithatë,

[54] Kurtesh Salihu, *Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e autonomitetit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në Jugosllavinë Socialiste* (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës: Prishtinë, 1984).
[55] Ibid., fq. 7-37.

nuk kishte qenë arsyeja e lindjes së **Malit të Zi** si një republikë ish-jugosllave, siç nuk kishte qenë as lindja e **Maqedonisë së Veriut** dhe **Republikës së Serbisë**: kjo e fundit kishte themeluar partinë e vet komuniste vetëm në fund të **Luftës së Dytë Botërore**, duke qenë në anën e forcave të nazi-fashizmit nga fillimi deri në fund; maqedonasit sllavë, gjithashtu nuk kishin dhënë ndonjë kontribut të njohur: ajo që njihet si **ASNOM** (versioni maqedonaso-verior i mbledhjes anti-fashiste, e udhëhequr nga komunistët, për gjoja rezistencë kundër nazi-fashizmit, kishte ndodhur nën diktatin serb dhe nuk kishte pasur asnjë peshë specifike në dëbimin e gjermanëve nga Ballkani).[56] Pas vitit 1945 ka ndodhur ridefinimi i

[56] **ASNOM** është shkurtesa për "Антифашистичко собрание за народно ослободување на Македонија" ("Këshilli Antifashist i Çlirimit të Maqedonisë"). Me pavarësimin e **Maqedonisë së Veriut**, me emërin e saj kushtetues "Republika e Maqedonisë", më 8 shtator 1991, në preambulën e **KMVe** ka qëndruar narrativi mbi **ASNOM**-in si "grundnormë" e parë e shtetësisë së këtij vendi, duke mos reflektuar realitetin historik. Diktatori komunist jugosllav, **Josip Broz Tito**, ka themeluar këtë republikë pas Luftës së Dytë Botërore për arsye të menagjimit të baraspeshës së forcëvë në shtetin që e udhëhoqi deri në vdekjen e tij më 1980. Në të njëjtën kohë, me themelimin e **Maqedonisë së Veriut**, ajo që për gati një shekull ishte njohur si "çështja maqedone" u mbyll për një kohë të pacaktuar. Kjo u bë e mundur për shkak se Lufta e Ftohtë kishte ndarë botën në dy pole, duke lënë Greqinë me kampin kapitalist, kurse Bullgarinë, Shqipërinë dhe Jugosllavinë në kampin komunist. Me prishjen e marrëdhënieve me **Stalinin** (Joseph Vissarionovich Stalin: 1878-1953) në vitin 1948, Jugosllavia mori primatin në **Ballkan** për faktin se u hap ndaj botës perëndimore në mënyrë graduale. Në këtë konstelacion të forcave, **Greqia** ngeli pa municion për të pretenduar dicka lidhur me Maqedoninë e Veriut. E njëjta ndodhi me **Bullgarinë** dhe **Shqipërinë**, të cilat deri në fund ngelën satelit sovjetik (kjo e fundit në versionin më të shëmtuar stalinist).

Vetëm pas prishjes së bllokut komunist dhe mbarimit të **Luftës së Ftohtë** u bë e mundur që të rikonceptiualizohet "çështja maqedone", por tani nga një dimension krejtësisht i ndryshëm nga ai i një shekulli më parë: **Maqedonia** Veriore u bë e pavarur, si një ish-republikë jugosllave, u njoh nga mbarë bota, por fqinjët e saj vënë disa rezerva, përfshirë edhe nga njëri ndër popujt përbërës të këtij shteti – shqiptarët. **Greqia** vuri veto në emrin e saj dhe kërkoj që shteti i ri të hiqte nga akti më i lartë juridik pretendimet territoriale ndaj fqinjëve si dhe të ndryshonte emërin e vet kushtetues. Fqinji tjetër, **Bullgaria**, kërkoj që të njihej ekzistenca e pakicës bullgare. Të gjitha këto kërkesa kërkonin ndryshime kushtetuese, të cilat një pas një i bëri Maqedonia e Veriut. Në fillim, pretendimet territoriale të vendit u rregulluan me amendamentet I dhe II të datës 6 janar 1992, me të cilën **Kuvendi i MVer** konstatoj se ky vend nuk kishte pretendime territoriale ndaj fqinjëve dhe nuk përzihej në të drejtat sovrane të vendeve të tjera e as në punët e tyre të brendshme. Me amendamentet XXXIII - XXXVI të datës 11 janar 2019, ndërkaq, **Kuvendi i MVer** përcaktoj se, emri i saj kushtetues, do të jetë "Maqedonia e Veriut", jo siç kishte qenë kur ky vend shpalli pavarësinë dhe u bë shtet sovran e i pavarur. Dhe, së fundi, populli shqiptar, pas një luftë të armatosur në vitin 2001 me forcat e rendit maqedonoi-verior dhe paramilitarët e këtij vendi, ka arritur të detyroj lidershipin sllav të këtij vendi për të avancuar pozitën juridik-kushtetuese të shqiptarëve, si një pakicë e konsiderueshme kombëtare. Materializim i këtij realizimi është **Marrëveshja e Ohrit**, që u lidh më datën 13 gusht 2001, e cila u kthye në norma kushtetuese, gjë që reflektohet me fillim nga premabula e **KMVer**, që u ndryshua më amendamentin IV të datës 16 nëntor 2001. Në fillim, teksti i preambulës kishte qenë kësisoj: "Duke u nisur nga trashëgimia historike, kulturore, shpirtërore dhe shtetërore e popullit maqedonas dhe nga lufta e tij shekullore për liri nacionale dhe sociale dhe për krijimin e shtetit të vet, e veçanërisht nga traditat shtetërore juridike të Republikës së Krushevës dhe vendimeve historike të KAÇKM-së dhe kontinuitetit kushtetues juridik të shtetit maqedonas si Republikë sovrane në Federatën Jugosllave, nga vullneti lirisht i shprehur i qytetarëve të Republikës së Maqedonisë në Referendumin e 8 shtatorit 1991, si dhe nga fakti historik se Maqedonia është konstituuar si shtet nacional i popullit maqedonas në të cilin sigurohet barazia e plotë qytetare dhe bashkëjetesa e përhershme e popullit maqedonas me shqiptarët, turqit, vllahët, romët dhe kombësitë e tjera që jetojnë në Republikën e Maqedonisë [...]". Me preambulën e ndryshuar, më shumë refektohet realiteti historik dhe etnik i këtij vendi, gjë që shihet nga teksti i saj që thotë si vijon: "Qytetarët e Republikës së Maqedonisë, populli maqedonas, si dhe qytetarët të cilët jetojnë brenda kufijve të saj të cilët janë pjesë e popullit shqiptar, popullit turk, popullit vlleh, popullit serb, popullit rom, popullit boshnjak e të tjerë, duke e marrë përsipër përgjegjësinë për të tashmen dhe të ardhmen e atdheut të tyre, të vetëdijshëm dhe mirënjohës ndaj paraardhësve të tyre për viktimat dhe përkushtimin e përpjekjeve të tyre dhe luftës për krijimin e shtetit të pavarur dhe sovran të Maqedonisë, dhe përgjegjës para gjeneratave të ardhshme për ruajtjen dhe zhvillimin e të gjithë asaj që është e vlefshme nga trashëgimia e pasur kulturore dhe bashkëjetesa në Maqedoni, të barabartë në të drejtat dhe obligimet e tyre për të mirën e përbashkët – Republikës së Maqedonisë - në përputhje me traditën e Republikës së Krushevës dhe vendimet e KAÇKM-së dhe të Referendumit të 8 shtatorit të vitit 1991, vendosën ta konstituojnë Republikën e Maqedonisë si shtet të pavarur, sovran, me qëllim që të vendoset dhe forcohet sundimi i së drejtës, që të garantohen të drejtat e njeriut dhe liritë qytetare, të sigurohet paqja dhe bashkëjetesa, drejtësia sociale, mirëqenia ekonomike dhe përparimi i jetës individuale dhe të përbashkët, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, të zgjedhur në zgjedhjet e lira dhe demokratike, e nxjerrin këtë [...]". Marrëveshja e Ohrit, përveç preambulës, u reflektua edhe në dispozitat tjera kushtetuese që kanë të bëjnë me pozitën e gjuhës shqipe në rendin juridik-kushtetues maqedon, kulturën e popullit shqiptar, të drejtat e qeverisjes lokale, arsimin dhe kështu me radhë. Cf. më shumë për zhvillimet politike në **Maqedoninë e Veriut** dhe në territorin ish-Jugosllav, që shpjegojnë transformimet dhe evoluimet e pozitës juridiko-kushtetuese të tri republikave ish-Jugosllave, fqinjë me

kufijve të shqiptarëve dhe trojeve të tyre etnike, me qëllim të themelimit të tri republikave të reja jugosllave: Serbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut. Kjo hyrje si më sipër, le të shërbej për të dalë te ideja e Millovan Gjilasit dhe shpjegimi i tij për lindjen e Republikës së Malit të Zi në Jugosllavinë komuniste: kur **Millovan Gjillas** i kishte thënë diktatorit jugosllav **Josip Broz Tito,** se Mali i Zi nuk kishte nevojë për republikë ngaqë nuk përbënte një komb të dallueshëm nga serbët, diktatori komunist Tito i kishte thënë se një republikë e **Malit të Zi** i duhej atij, diktatorit komunist jugosllav, jo serbëve dhe malazezëve, për të diktuar dhe manipuluar baraspeshën e brendshme të forcave mes kombeve dhe popujve të ish-Jugosllavisë, si mënyrë e tij e udhëheqjes me shtetin e ri komunist.[57] Kjo qasje ishte në tërësi në frymën e diktatorit sovjetik **Stalin**, i cili kishte zhvilluar teorinë dhe praktikën e vetëvendosjes komuniste, sipas së cilës popujt jo sllav duheshin shpërndarë dhe shprishur sa më shumë, përfshirë përmes krijimit të entiteteve të reja politiko-territoriale, duke i lënë ata në pakicë josllavët që do të jetonin nëpër këto entitete të reja. Kjo politikë ka qenë gjerësisht e zbatuar krahas spastrimit etnik të popujve të padëshirueshëm në ish-Bashkimin Sovjetik, kryesisht me origjinë josllave dhe joruse.[58] Kjo shpjegon edhe ndërtimin e tri republikave të reja ish-jugosllave pas Luftës së Dytë Botërore (Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi dhe Serbisë), duke marrë pjesë nga territori etnik me shumicë shqiptare. Edhe rirregullimet administrativo-politike të territorit të Kosovës së sotme në vitet ’60 të shekullit të kaluar, kryesisht në veri të saj, kanë qenë pjesë e këtij koncepti për prishjen e homogjenitetit etnik të vendit.

Me këtë hyrje të shkurtër, duam të tregojmë se trajtimi ynë i autonomisë së **Kosovës** ka të bëj ekskluzivisht me aspektin **juridiko-kushtetues**, ashtu siç është paraqitur ajo në të gjitha kushtetuat e Jugosllavisë komuniste, asnjëherë me anën ideologjike. Për këtë, siç e theksuam në fillim të këtij seksioni, gjerësisht jemi mbështetur në librin e profesorit të ndjerë **Kurtesh Salihu**. Çdo gjë fillon me mbarimin e **Luftës së Dytë Botërore**, mirëpo vëllimi dhe cilësia e autonomisë së Kosovës nga viti 1946 e këndej dallon dukshëm nga një kohë në tjetrën.

Kushtetuta e parë e Jugosllavisë komuniste e vitit 1946 (KJ 1946) për herë të përcakton autonomitë e saj, përfshirë atë të Kosovës. Siç dihet, me **KJ 1946** sanksionohet rregullimi federal i shtetit, me republikat federale si subjekte të vetme konstitutive. Kosova si autonomi figuron nën juridiksionin e **Republikës së Serbisë**, karakteristikë kjo juridiko-kushtetuese që nuk ka ndryshuar asnjëherë deri në shpërbërjen e atij shteti. Në nenin 2.2 të **KJ 1946** përcaktohej se “Republika Popullore e Serbisë ka në kuadrin e saj Krahinën Autonome të Vojvodinës dhe Krahinën Autonome të Kosovës dhe Metohisë” (siç quhej Kosova deri në amendamentet kushtetuese të vitit 1968) Në funksionet federative ka qenë edhe dhënia e pëlqimit nga Federata për formimin e krahinave autonome dhe pranimi i republikave të reja (neni 44.2

Kosvën, në burimet si vijon: R. W. Seton-Watson, “The Yugoslav Constitutional Position” The Slavonic and East European Review Vol. 23 No. 62 (January 1945), fq. 85-96; Edgar O’ Balance, *The Greek Civil War, 1944–1949* (Faber & Faber: London, 1966); Milovan Djilas, *Tito: The Story from Inside* (Harcourt Brace Jovanovich: New York, 1980); Ben Bagwell*, ”*Yugoslavian Constitutional Questions: Self-Determination and Secession of Member Republics” *Georgia Journal of International and Comparative Law* Vol. 21 No. 3 (1991), fq. 489-523, në fq. 493, 495, 497-514; Robert M. Hayden, “Constitutional Nationalism in the Formerly Yugoslav Republics *Slavic Review* Vol. 51 No. 4 (Winter, 1992), fq. 654-673; Peter Radan, *The Break-up of Yugoslavia and International Law* (Routledge: London and New York, 2002); Kate Transchel, *The Breakup of Yugoslavia: Conflict in the Balkans* (Chelsea House: New York, 2007); Nikos Marantzidis, “The Greek Civil War (1944–1949) and the International Communist System” *Journal of Cold War Studies* Vol. 15, No. 4 (Fall 2013), fq. 25-54; Ljubica JANČEVA, “THE PRINCIPLES OF ASNOM AND THE CONSTITUTIONAL HISTORIC LEGACY FOR THE “FRAMEWORK” REPUBLIC OF MACEDONIA”. *Politeja* No. 30, Macedonia in 20th and 21st century (2014), fq. 71-78; James Horncastle, *The Macedonian Slavs in the Greek Civil War, 1944-1949* (Lexington Books: London and New York, 2019), fq. 59-69.

57 Marko Prelević, “Titu sam rekao ‘Crnogorci jesu Srbi’. A on mi je odgovorio: ‘Dobro, ali nama sada treba Republika’…”: Šta je stvarno mislio Milovan Đilas”. *NEDELJNIK* 19/07/2020. Në internet: https://www.nedeljnik.rs/titu-sam-rekao-crnogorci-jesu-srbi/ (shikuar më 20 prill 2023).

58 Cf. më shumë në Michael V. Kryukov, “Self-determination from Marx to Mao”. *Ethnic and Racial Studies* Vol. 19 Issue 2 (1996), fq. 352-378.

pika 2 e **KJ 1946**). Përveç kësaj, KJ 1946 ka përcaktuar edhe parimet themelore për organizimin dhe funksionimin e autonomisë si dhe organet më të larta të pushtetit në krahinën autonome. Caktimi i të drejtave dhe fushëveprimi i autonomisë, ndërkaq, kanë qenë në kompetencë të Republikës së Serbisë. Kushtetuta e Republikës Popullore të Serbisë e vitit 1947 (KS 1947), duke u nisur nga **KJ 1946**, përcaktonte kompetencat dhe organizimin më në hollësi të krahinave autonome. Sipas **KS 1947**, krahina ka nxjerrë statutin, si akt të vetin më të lartë, i cili duhej të ishte në pajtim me **KJ 1946** dhe **KS 1947**, i cili vërtetohej në **Kuvendin Popullor të Republikës së Serbisë** (KPRS) (**KJ 1946**, neni 104). Në bazë të këtij autorizimi, **Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë** (KAKM) ka nxjerrë më 23 maj 1948 Statutin e parë.

Organi më i lartë i pushtetit popullor i **KAKM** ka qenë **Këshilli Popullor Krahinor** (KPK), të cilin e zgjeshnin qytetarët me mandat prej tre vjetësh (**KJ 1946**, neni 106.1). KPK-ja është ekskluzivisht i autorizuar të nxjerrë dhe ndryshoj statutin, të zgjedhë dhe të shkarkoj organin ekzekutiv, **Këshillin Ekzekutiv Krahinor** (KEK), të nxjerr planin dhe buxhetin e krahinës, të nxjerrë dispozita të përgjithshme dhe vendime, të caktoj taksat krahinore në bazë të ligjit, të bëj ndryshimin e kufijve të rretheve, të qyteteve dhe të këshillave popullor të vendit, me vërtetimin e **Presidiumit të Kuvendit Popullor të Serbisë** (KS 1947, neni 107). Akti më i lartë i KPK, pas statutit si akt i përgjithshëm, ka qenë vendimi. Në këtë periudhë, KAKM-ja nuk ka gëzuar autonomi gjyqësore, për dallim nga autonomia tjetër e kohës – **Vojvodina**, e cila ka pasur **Gjykatën Supreme**, si instancën më të lartë gjyqësore në krahinë. Këtu, pra, shihet një **diskriminim** i hapur i Kosovës dhe kjo tregon se arsyetimi ideologjik i lindjes së autonomisë nuk ka pasur asnjë relevancë, por raporti real i forcave brenda ish-Jugosllavisë. Kjo ka qenë kështu tërë kohën, deri në shkatërrimin e atij shteti në pranverë të vitit 1992. Në territorin e KAKM-së kanë qenë formuar gjykatat e rretheve dhe katër gjykata të qarkut, si gjykata të shkallës së dytë. **KAKM-ja** ka qenë e përfaqësuar drejtpërdrejtë në Kuvendin Popullor të Jugosllavisë, në **Dhomën e Kombeve**, nëpërmjet të delegacionit të vet të përbërë prej 15 deputetësh (KJ 1946, neni 54). Marrëdhëniet juridiko-kushtetuese e KAKM-së me Serbinë dhe Jugosllavinë si dhe pozita e saj juridiko-kushtetuese kanë qenë shumë inferiore. Në bazë të **KS 1947**, Kuvendi i Serbisë ka pasur të drejtë të shpërndaj KPK-në dhe t'i shpallë zgjedhjet për zgjedhjen e Këshillit të ri, si dhe ta shkarkoj KEK. Presidiumi i Kuvendit Popullor të Serbisë ka pasur të drejtë t'i abrogoj dhe anuloj vendimet e KPK-së, nëse ato nuk kanë qenë në pajtim me **KJ 1946** dhe ligjet federative, m dekretet e Presidiumit të Kuvendit të Jugosllavisë dhe të Kuvendit të Serbisë, si dhe me Statutin e KAKM-së. Për arsye të njëjta, qeveria e Serbisë ka pasur të drejtë t'i anuloj aktet e **KEK**, ndërsa anëtarët e qeverisë – aktet e të besuarve të **KEK**.

Në autonomitetin e **KAKM-së** nuk ka ndodhur ndonjë ndryshim esencial as në vitet 1953-1963. Në janar të vitit 1953 u nxor **Ligji Kushtetues i Jugosllavisë** (LK 1953), me të cilin dyshohen disa dispozita kushtetuese të **KJ 1946**. Pas tij, në shkurt të vitit të njëjtë u nxor **Ligji Kushtetues i Serbisë** (LKS 1953), si dhe Statuti i ri i **KAKM-së** (shkurt 1953) (SK 1953). Me **LK 1953** nuk suprimohet neni 2 i **KJ 1946**: krahinat edhe më tutje përmenden si njësi autonome në kuadrin e Republikës së Serbisë. **LK 1953** suprimoj kreun XI të **KJ 1946** lidhur me organet e pushtetit shtetëror në krahinat autonome (**Kosovë** dhe **Vojvodinë**), duke e zëvendësuar me një kaptinë të re (IV), të emërtuar "Dispozitat parimore mbi organet e pushtetit të krahinës autonome", në të cilën, në prizmin e vetëqeverisjes shoqërore, teorisë dhe praktikës së re të komunizmit jugosllav që u instalua në vitin 1953, sigurohen të drejtat e krahinës dhe parimisht caktohen organizimi dhe organet e saj. Me **LK 1953** abrogohet edhe dispozita e nenit 44 të KJ 1946, me të cilin Federata ishte e autorizuar për pranimin e republikave të reja dhe vërtetimin e formimit të krahinave të reja autonome. Më këtë, siç shihet, në aspektin juridiko-kushtetues mbyllet dera për themelim të republikave e krahinave të reja dhe për çfarëdo ndryshimi të rregullimit shtetëror të Jugosllavisë komuniste, duke ngelur një shtet federal me njësi federale të tipit të republikave federale dhe me autonomi fiktive politike, të tipit të krahinave që nuk kanë qenë veçse regjione administrative me organe pa asnjë përmbajtje të përfaqësimit politik. Me fjalë të tjera, edhe në këtë periudhë, lirisht mund të thuhet se, KAMK-së më shumë ka qenë një regjion se një autonomi politike, nisur nga fakti i thjeshtë se, Kosova në këtë kohë, nuk ka pasur të drejtën e nxjerrjes së ligjeve. Aktiviteti i saj normativ

ka qenë shumë i ulët dhe tërësisht i diktuar nga hierarkia akteve juridike të Republikës së Serbisë dhe pa asnjë juridiksion burimor normativ në rang ligjvënie. Ka qenë ligji serb ai që ka qenë origjina e statutit të KAKM-së. Për pasojë, ky status juridiko-kushtetues, ka qenë në tërësi i reduktuar në një regjion autonom pa asnjë kompetencë burimore, përkatësisht në një regjion me autonomi administrative dhe aspak politike. Organet e pushtetit vendor në **KAKM-së** në tërësi kanë shprehur vullnetin e Republikës së Serbisë, pjesë e së cilës ka qenë formalisht dhe në aspektin përmbajtësor. Se kjo ka qenë kështu, në aspektin ë të drejtës kushtetuese, reflektohej edhe në dispozitat formalo-juridike të kohës, të cekura më sipër: me nenin 113 para. 1 dhe 2 të LK 1953 siguroheshin të drejtat autonome të **Krahinës Autonome të Vojvodinës** (KAV) dhe **KAKM-së**, mirëpo përcaktimi i tyre ngelej në kompetencë ekskluzive të Kushtetutën e Serbisë. Në këtë mënyrë, federata as në mënyrë të përgjithshme nuk i përcaktonte të drejtat e krahinave autonome, por e autorizonte Republikën e Serbisë që këtë ta bënte me aktin e saj më të lartë – **LKS 1953**. Në bazë të autorizimeve të tilla, LKS 1953 e përcakton pozitën e krahinave në mënyrë më të hollësishme se sa **KS 1947**. Pasi konstaton se Republika e Serbisë në kuadrin e ka **KAV** dhe **KAKM**, në nenin 114, **LKS 1953** përcaktonte se populli punues i krahinave autonome, duke realizuar vetëqeverisjen në komunë, qytet e rreth, zgjedh organet krahinore të pushtetit dhe nëpërmjet tyre ushtron të drejtat e veta të caktuara me KS 1947. Këto të drejta përcaktoheshin në suazat e të drejtave të cilat u janë caktuar me KS1947 dhe ligj organeve republikane të pushtetit. Nga kjo qartë vërehet se, sipas LKS 1953, të drejtat e krahinave autonome kanë qenë të drejta të cilat Republika e Serbisë i kalonte në këto njësi. Më fjalë të tjera, krahina në këtë fazë të zhvillimit kushtetues **ka humbur të drejtat e saj origjinere**, nëse mund të thuhet se ato kanë ekzistuar formalisht në periudhën 1947-1953. Organet e **KAKM-së** ngelin të njëjta dhe akti juridik më i lartë i saj ngelet i njëjtë, pra, statuti. Sa i përket organit përfaqësues, vlen të theksohet se, edhe në këtë periudhë ekziston epërsia e organit ekzekutiv republikan ndaj organit përfaqësues të KAKM-së, i cili gëzon **të drejtën e shpërbërjes** së këtij të fundit në çdo kohë dhe **anulimit** të çdo akti që ka mund të nxjerr, përfshirë Statutin. Kjo gjendje si më sipër lidhur me autonomitetin fiktiv të KAKM-së ka ekzistuar pa ndërprerje edhe pas nxjerrjes së **Kushtetutës së Jugosllavisë** të vitit 1963 (KJ 1963), në të cilën është bazuar Kushtetuta e Serbisë e po atij vitit (KS 1963). Kjo e fundit, KS 1963, në detaje ka përpunuar statusin, të drejtat e detyrat dhe organizimin e krahinave autonome. Si arsye themelore për formimin e tyre, KS 1963 vinte në pah veçoritë e zhvillimit të tyre historik e kulturoro-arsimor, si dhe përbërjen e veçantë kombëtare të popullsisë së këtyre trevave. Me këtë qartë shihet se, arsyet ideologjike që lidhen me kontributin e shqiptarëve dhe hungarezëve kundër nazi-fashizimit, as që kanë qenë të përmendura dhe as që kanë pasur ndonjë relevancë. Ka qenë raporti i forcave në favor të serbëve në këtë kohë ai që ka çuar peshë, asgjë tjetër.

Vetëm pas vitit 1967 nis një fazë e ndryshimeve pozitive për autonominë e Kosovës e cila, në fund, me nxjerrjen e **Kushtetutën RSFJ 1974**, dhe të kushtetutës së Kosovës dhe Serbisë të atij viti, merr trajtën e një autonomie të mirëfilltë politiko-territoriale. Në vitin 1966 bie nga pushteti serbi **Aleksandër Rankoviq** (Aleksandar Ranković: 1909-1983), zëvendësi i diktatorit komunist **Tito**, njeriu që kishte udhëhequr policinë sekrete komuniste, e njohur si **UDBA** ("Uprava Državne Bezbednosti"), e cila kishte territorizuar shqiptarët në ish-Jugosllavi, duke i vrarë e torturuar dhe duke i detyruar të shpërnguleshin nga vatrat e tyre për në **Turqi** e gjetiu.[59] Rankoviqi, në fakt, i kishte parë shqiptarët si

[59] Se kishte pasur terror ndaj shqiptarëve, diskriminim masiv, e pranon në memoaret e tij vetë protagonisti i terrorizimit të shqiptarëve. Cf. Aleksandar Ranković, *Dnevničke zabeleške* (Jugoslovenska knjiga: Beograd, 2001); Cf. edhe Bojan Dimitrijević, *Ranković – drugi* čovek (Vukotic media: Beograd, 2019). Dy librat janë në gjuhën serbe, me alfabet cirilik. Për shpërnguljet dhe dhunën terrorizuese ndaj shqiptarëve në ish-Jugosllavi, pra jo vetëm në Kosovë, përfshirë edhe popullsinë mulsimane boshnjake, cf. më shumë në: Julie Mertus, *Kosovo: Hoë myths and truths started a war* (University of California Press: Berkeley, 1999), fq. 98; Independent International Commission on Kosovo (2000). *The Kosovo report: conflict, international response, lessons learned* (Oxford University Press: New York, New York, 2000), fq. 35; Vjekoslav Perica, *Balkan idols: Religion and nationalism in Yugoslav states* (Oxford University Press: Oxford, 2002), fq. 43–44; Lazar Nikolić, "Ethnic Prejudices and Discrimination: The Case of Kosovo". Në Florian Bieber, Židas Daskalovski (eds.), *Understanding the war in Kosovo* (Psychology Press: London, 2003), fq. 59; Denisa Kostovicova, *Kosovo: The politics of identity and*

një rrezik sigurie në Jugosllavisë komuniste, ashtu që tërë kohën ishte kujdesur për të neutralizuar çdo përpjekje të shqiptarëve për emancipim, autonomi dhe pavarësi nga Serbia.[60] Kjo kohë në Kosovë njihet si **koha e Rankoviqit**.[61] Me heqjen qafe të **Rankoviqit** dhe agjendës së tij anti-shqiptare, vjen deri te ngritja në pushtet e reformistëve jugosllav që kërkonin decentralizim dhe ruajtjen e të drejtës për vetëvendosje kombëtare të popujve të atij shteti.[62] Klima që u krijua pa rrëzimit të **A. Rankoviq** (në vitin 1966 në atë që njihet gjerësisht si Plenumi i Brioneve),[63] ishte në favor të shqiptarëve, sepse në nivel të Jugosllavisë u bë e ditur çfarë kishte ndodhur me ta. Republikat veriore, kroatët e sllovenët, ishin të pajtimit që shqiptarët duheshin trajtuar ndryshe dhe si të barabartë me sllavët. Vetë **Tito** ishte kroat, kurse kuadrot kryesore që drejtonin ish-Jugosllavinë në kohën e Titos ishin nga veriu i vendit, gjë që bëri të mundur realizimin e një autonomiteti më të madh të shqiptarëve në Kosovë dhe gjetiu në trojet e tyre autoktone në ish-Jugosllavi, gjë që u reflektua në tekstet kushtetuese të viteve 1967, 1968 e deri në vitin 1974 kur u nxor kushtetuta e Jugosllavisë dhe kushtetutat e republikave dhe krahinave autonome. Vendet fqinje me Kosovën, Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi u detyruan të ndjekin një politikë më jodiskriminuese ndaj shqiptarëve. Ne trajtojmë këtu vetëm **Kushtetutën e Kosovës** të vitit 1974 (Kushtetuta e KSAK-së), si dhe amendamentet kushtetuese që i kanë paraprirë nxjerrjes së saj.

Me amendamentet e vitit 1967 dhe 1968 është ndryshuar **KJ 1963**. Këto kanë shërbyer si bazë kushtetuese për ndryshimet përkatëse lidhur me krahinat autonome edhe në **KS 1963** si dhe në aktin më të lartë të vetë krahinave autonome. Me këto ndryshime, dukshëm ndryshon pozita e autonomisë, në krahasim me atë të sanksionuar në **KJ 1963**, si dhe **LK 1953**. Me këto amendamente kushtetuese, autonomitë kthehen në KJ 1963 dhe, për pasojë, atyre u sigurohet një pozitë e re në Federatë, në organet e së cilës vendosej për çështjet qenësore të pozitës së kombeve dhe kombësive (siç quheshin shqiptarët, hungarezët dhe popujt tjerë që nuk kishin republikat e tyre federale në atë shtet). Kjo u reflektua në veçanti në amendamentet I-IV të miratuara më 18 prill 1968, me të cilat u fut **Dhoma e Kombeve e Kuvendit Federativ**, në të cilën krahina dërgonin nga dhjetë deputetë (kurse republikat nga njëzetë), u ndryshua përbërja e **Qeverisë Federative**, e njohur si Këshilli Ekzekutiv Federativ dhe e organeve federale të administratës. Bazë për ndryshim radikal të pozitës së krahinave autonome, megjithatë, ka qenë amendamenti XVIII i datës 26 dhjetor 1968 (këtë ditë janë miratuar amendamentet VII-XIX në KJ 1963). Me amendamentin XVIII këtë amendament krahinat definohen si ”bashkësi socialiste demokratike shoqërore-politike me përbërje të veçantë kombëtare dhe veçori të tjera” (pika 2). Në këtë mënyrë, krahinat autonome përcaktohen dhe vërtetohen në mënyrë të ngjashme si edhe republikat, por pa pasur statusin e njëjtë juridiko-kushtetues të njësisë federale si republikat. Ato ushtrojnë funksione të ngjashme me republikat, përveç atyre që përcaktohet si funksione republikane unike. Krahinat tani gëzojnë mbrojtjen e integritetit dhe tërësisë së tyre territoriale, që mund të ndryshonte vetëm me pëlqimin e vetë krahinave, si dhe iu lejohet nxjerrja e ligjit kushtetues, si akti më i lartë në nivel të krahinës. Kosova ka nxjerr ligjin e parë kushtetues më 24 shkurt 1969 (LKKos 1969). Prej akteve të tjera normative, krahina nxjerr ligje, jo vetëm vendime siç ka qenë deri në këto amendamente. Përveç kësaj, me amendamentet VII-XIX të 26 dhjetorit 1968, Kosovës i hiqet shtojca ”e Metohisë” dhe emërtohet si ”Krahina Socialiste Autonome e Kosovës” (KSAK), njëjtë sikur Vojvodina (“Krahina Socialiste Autonome e Vojvodinës”). Kosova fiton **Gjykatën Supreme** dhe organet tjera të drejtësisë, njëjtë sikur në republikat e ish-Jugosllavisë. Autonomiteti i Kosovës, i zgjeruar me nxjerrjen e **LKKos 1969** dhe

space (Routledge: London, 2005), fq. 40, 121; Klejda Mulaj, *Politics of ethnic cleansing: nation-state building and provision of in/security in twentieth-century Balkans* (Lexington Books: New York etc., 2008), fq. 45.

60 Dick Leurdijk and Dick Zandee, *Kosovo: From crisis to crisis* (Routledge: London and New York, 2001), fq. 15; Barry J. Ryan, “Policing the state of exception in Kosovo”. Në Aidan Hehir (ed.), *Kosovo, Intervention and Statebuilding: The International Community and the Transition to Independence* (Routledge: London and New York, 2010), fq. 114–131; Roger D. Petersen, *Western Intervention in the Balkans: The Strategic Use of Emotion in Conflict*. (Cambridge University Press: Cambridge: 2011), fq. 142.

61 Edina Bećirević, Edina (2014). *Genocide on the Drina River* (Yale University Press: Yale, 2014), fq. 17.

62 Melissa Katherine Bokovoy, Jill A Irvine, Carol S. Lilly, (1997). *State-society relations in Yugoslavia, 1945-1992* (Palgrave Macmillan: Scranton, Pennsylvania, USA, 1997), fq. 295-296.

63 Cf. më shumë për rrëzimin nga pushteti të **A. Rankoviq** si dhe jehonën që kjo ka pasur në ish-Jugosllavi, në punimin shkencor analitik të Katarina Spehnjak, “Brionski plenum’- odjeci IV. sjednice CK SKJ iz srpnja 1966. godine u hrvatskoj političkoj javnosti”. Časopis za suvremenu povijest Vol. 31 No. 3 (1999), fq. 463-489.

ligjeve si akte normative më të rëndësishme, ka shtruar edhe çështjen e mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë krahinore. Kjo çështje zgjidhet me formimin e **Degës Kushtetuese-Gjyqësore pranë Gjykatës Supreme të Kosovës** (DKusht).

Amendamentet kushtetuese në KJ 1963 të vitit 1971 kanë pasur të bëjnë me sistemin e menaxhimit vetëqeverisës të ish-Jugosllavisë, të cilat kanë çuar në decentralizim ekonomik dhe fuqizim të republikave dhe krahinave autonome si njësi ekonomike, kundrejt federatës. **Kushtetutën RSFJ 1974** nuk bën asgjë pos sanksionon dhe kodifikon pozitën e krahinave autonome, përgjatë vijave të tërhequra me amendamentet 1967-1971 në KJ 1963. Tani krahinave iu njihet e drejta për nxjerrjen e kushtetutave të tyre (**Kushtetuta e KSAK**), për epërsinë e të cilës kujdesej **Gjykata Kushtetuese e KSAK** (e formuar më 1972), e cila zëvendësoi **DKusht** që kishte funksionuar brenda **Gjykatës Supreme**.

Autonomiteti i fituar me Kushtetutën e KSAK-së u rrënua më 23 mars 1989 nga diktatori serb **Slobodan Millosheviq**, nxiti homogjenitetin e shqiptarëve të Kosovës, të cilët u organizuan në parti politike nacionale dhe iu kundërvunë në çdo aspekt regjimit serb. Zhvillimin kushtetues të Kosovës së kësaj kohe, përfshirë edhe periudhën e luftës së armatosur të **UÇK** (1998-1999) (UÇK*),* e kemi shtjelluar në pjesët pararendëse.[64] Këtu mjafton të ritheksojmë sërish ngjarjet që janë zhvilluar pas pavarësimit real të Kosovës, gjithnjë nga aspekti juridiko-kushtetues. Pas pavarësimit të Kosovës më 17 shkurt 2008, ka pasuar njohja e saj si një shtet sovran dhe i pavarur nga pjesa dërrmuese e vendeve perëndimore dhe aleatëve të tyre nga katër anët e botës. Më 22 korrik 2010, **Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë** (GJND) konfirmoj në një mendim të vetin këshillëdhënës se **Deklarata e Pavarësisë së Kosovës**, si akt i njëanshëm juridik në të drejtën ndërkombëtare, nuk kishte qenë në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, të përgjithshme dhe të veçantë.[65] Ky mendim, përmes **Asamblesë së Përgjithshme** të OKB-së (AP), ishte kërkuar nga Serbia, e cila sot e kësaj dite konteston fuqishëm pavarësinë e Kosovës dhe, përmes aleatëve të saj, në rend të parë Rusisë dhe Kinës, por edhe satelitëve të tyre, bën çdo gjë për të detyruar shtetet njohëse të pavarësisë së Kosovës që të tërheqin njohjet e tyre. Pas vendimit të GJND-së, që tha se vullneti i shprehur i Kuvendit të Kosovës për shpalljen e pavarësisë së vendit kishte ndodhur jashtë rendit juridik të krijuar nga OKB-ja përmes rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999). Kur mendimi iu kthye kërkuesit të tij, **AP**, atëherë kjo nxori një rezolutë që kërkonte nga palët që përmes dialogut të zgjidhnin mosmarrëveshjet e tyre.[66] Dialogu ka nisur në vitin 2011 dhe që atëherë ka prodhuar disa marrëveshje mes palëve, shumica nga të cilat kanë ngelur pa u implementuar. Ndër to më e rëndësishmja është **MO** që u shtjellua gjerësisht më sipër.[67] Esenca e **MO** ka qenë dhe ngelet krijimi i një autonomie për serbët lokal, e formësuar në trajtën territoriale dhe joterritoriale, fund e krye asiemtrike, ku një organizëm i quajtur **A/BKS**, shërben me organet e veta si **institucion ombrellë** për realizimin e kësaj autonomie serbe. Në ndërkohë që shqiptarët mëtojnë të krijojnë një asociacion me autorizime nga e drejta private, serbët insistojnë në krijimin e një **bashkësie të komunave serbe**, si një entitet autonom nga pushteti qendror, që përkujdeset për serbët lokal duke përjashtuar dhe rivalizuar pushtetin shtetëror kosovar në çdo cep të tij dhe në secilin segment të manifestimit të shtetësisë së Kosovës. I dyti, pra **A/BKS**, mëtohet të operoj në terrenin e të drejtës publike, me autorizime burimore dhe të pavarura në tërësi nga **Republika e Kosovës**, dhe me lidhje të drejtpërdrejtë me shtetin serb.

---

64 Shih seksionin 27.1 në këtë pjesë të këtij libri.

65 Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo, Advisory Opinion of 22 July 2010 I.C.J. Reports (2010).

66 Në paragrafin e parë, **Rezoluta e AP-së** merr në dijeni pranimin e mendimit këshillëdhënës të **GJND-së** për Kosovën, i bërë sipas kërkesës së saj, kurse në të dytin mirëpret gatishmërinë e BE-së për të lehtësuar procesin e dialogut mes palëve. Në këtë paragraf, AP tutje thekson se ai dialogu në vetvete do të jetë një fakt për paqen, sigurinë dhe stabilitetin në rajon dhe do të shërbej si një promovues i bashkëpunimit dhe arritjes së progresit në rrugën për në BE dhe përmirësim të jetesës së popujve. Cf. *Resolution adopted by the General Assembly. A/RES/64/298.* Në internet: https://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D / ROL %20A% 20RES64 %20298.pdf (shikuar më 22 prill 2023).

67 Cf. Seksioni 6.1, **supra** në këtë pjesë të librit.

Sikundër shihet, bazuar në memoaret e **Katherin Ashton**, që ka ndërmjetësuar realizimin e **MA 2013**, ideja nuk ka qenë për ndërtimin e ndonjë strukture autonome serbe, por për themelimin e një trupi koordinues të ngjashëm me atë që ekziston për komunat aktuale në Kosovë.[68] Ky nuk është rasti, megjithatë, me MO, e cila e bën të qartë se në Kosovë do të ndërtohet një **autonomi jo-territoriale**, përmes **institutit të vetëmenaxhimit**, dhe një tjetër me **karakter territorial** që në rend të parë nënkupton **KOS**, por edhe territorin e veriut të Kosovës, në të cilin do të vendoset selia e **A/BKS** (që me gjasë shumë të madhe nuk do të jetë dhe as nuk do të quhet **Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe**). Në momentin e shkrimit të këtyre rreshtave (22 prill 2023), akoma nuk dihen qartë përmasat e autonomitetit serb në Kosovë. Ajo që dihet është kjo: autonomia e tyre nuk është qëllim përfundimtar i Serbisë, por një mjet për arritjen e qëllimeve të tjera – restaurimin e sovranitetit serb në Kosovë. Përveç kësaj, qartë dihet se, siç e pamë më sipër, më shumë ka gjasë që Kosova të shkoj kah një lloj shteti me **decentralizim asimetrik**, i fortë dhe në favor ekskluziv të komunitetit serb, diçka që seriozisht rrezikon kohezivitetin shoqëror dhe diskriminon komunitetet tjera. Ajo që shohim duke u shpalosur është niveli më i lartë i **decentralizimit asimetrik** në favor të një komuniteti etnik dhe fetar – serbëve. Ky decentralizim përbëhet prej dy komponentëve: një, komponenti i **autonomisë territoriale** në raport me **KOS**, e cila pritet të gëzoj një **ekstraterritorialitet të plotë**, si formë gjithëpërfshirëse e autonomisë fetare; dhe, dy, komponenti i **autonomisë joterritoriale** të komunitetit serb, me të drejtën e tij për **vetëmenaxhim të plotë** të punëve që kanë të bëjnë me te, model ky i ngjashëm me **sistemin e kapitulacioneve** në ish-**Perandorinë Osmane** dhe në disa perandori të tjera aziatike të shek. XIX (**Japonia**, **Kina** etj.).[69] Ky autonomitet serb, si forma më avancuar e decentralizimit asimetrik në **Ballkan**, nuk është qëllim i nacionalizmit serb, por vetëm një mjet i këtij nacionalizmi për arritjen e një qëllimi tjetër më sublim – restaurimin e sovranitetit juridik (formal) mbi Kosovën, me pasojë rikthimin e ushtrisë serbe në Kosovë sipas standardeve të rezolutës 1244 të **Këshillit të Sigurimit të OKB-së** dhe përtej, pengimin e formimit të një ushtrie unike për territorin e Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur dhe kështu me radhë. Krejt kjo me shpresën se një ditë mund të rikthehet çështja e statusit të Kosovës në **GJND** dhe forumet tjera të rëndësishme ndërkombëtare.

9.2. Shqipëria

I vetmi moment që në **Shqipëri** mund të ketë pasur një përpjekje serioze për njohjen e autonomisë politiko-territoriale ka qenë propozimi i **Ismail Qemailit** për **regjionalizimin** e vendit. Këtë e shtjelluam më sipër te pjesa për regjionalizimin në kontekstin shqiptar. Ai propozim ka qenë konceptualisht përpjekje për dhënien e **autonomisë politiko-territoriale** regjioneve të caktuara të Shqipërisë, për ndërtimin e një

[68] Cf. më shumë në Catherine Ashton, *And Then What?: Inside Stories of 21st-Century Diplomacy*, fq. 109-145.

[69] Për sistemin e kapitulacioneve, cf. më shumë në Lucius Ellsworth Thayer, "The Capitulations of the Ottoman Empire and the Question of their Abrogation as it Affects the United States" *The American Journal of International Law* Vol. 17 No. 2 (April 1923), fq. 207-233 (autori përshkruan origjinën e kapitulacioneve, me fillim nga koha e *Perandorisë Romake*, si një *modus vivendi* për bashkëjetesë përgjatë historisë të kulturave, racave dhe feve të ndryshme, bazuar jo në territor, por në shtetësi, përkatësisht në cilësitë personale të pjesëtarëve të grupeve të caktuara; më pastaj, shkrimi flet për pasojat juridike që kanë prodhuar kapitulacionet në shtetet e treta për më shumë se katërqind vjet të ekzistencës së tyre në territorin otoman, që kanë pasur të bëjnë kryesisht me kristianët dhe të drejtat e liritë e tyre në territorin otoman); Feroz Ahmad, "Ottoman Perceptions of the Capitulations: 1800–1914". *Journal of Islamic Studies* Vol. 11 No. 1 (January 2000), fq. 1-20 (autori tregon se otomanët i kanë cilësuar kapitulacionet si privilegje të jashtëzakonshme, të bëra ndaj fuqive të treta në mënyrë të njëanshme nga otomanët, të cilat kanë mund të tërhiqen në cdo kohë dhe pa ndonjë vështirësi; në praktikë, megjithatë, kjo nuk ka qenë kështu, sepse kapitulacionet kanë ekzistuar për katërqind vite dhe nuk janë anuluar deri me themelimin e Republikës së Turqisë më 29 tetor 1923); David P. Fidler, "A Kinder, Gentler System or Capitulations? International Law, Structural Adjustment Policies, and the Standard of Liberal, Globalized Civilization". *Texas International Law Journal* Vol. 35 No. 3 (July 2000), fq. 387-414 (ku autori flet për kapitulacionet si privilegje, përmes së cilave shtetasit e krishterë të Evropës dhe SHBA-ve kishin qenë të përjashtuar nga juridiksioni otoman administrativ, civil dhe penal, si dhe nga çdo juridiksion tjetër, duke i lënë ata të nënshtruar vetëm ndaj ligjeve të vendit të origjinës; sipas tij, kapitulacionet kanë qenë standard hegjemonik i perëndimorëve ndaj kulturave dhe popujve të tjerë, që është imponuar si një mënyrë perëndimore e jetesës dhe zhvillimit socio-politik); Christina Bell, Capitualtions. *Max Planck Encyclopedia of Public International Law* (July 2009). Në internet: https://opil.oupLaw.com/display /10. 1093/ Law:epil/9780199231690/Law-9780199231690-e260 (shikuar më 17 prill 2023).

shteti sipas modelit zviceran, një lloj konfederate e fiseve dhe regjioneve shqiptare. Nuk do mend që ky propozim, sikur të ishte vënë në jetë, do të kishte çuar në procese tjera dezintegruese, sepse do kishte shprishur kohezivitetin shoqëror të fiseve dhe regjioneve shqiptare, si rrjedhojë e veprimit të forcave centrifugale të ndikuara nga faktorët gjeopolitike të vendit. Disa forma të manifestimit të këtyre forcave centrifugale edhe sot e kësaj dite vërehen nëpër trojet shqiptare në **Shqipëri** dhe përtej saj.

9.3. Maqedonia Veriut

Maqedonia Veriut është shtet unitar dhe i decentralizuar. Në historinë më të re të këtij vendi, pas pavarësimit të tij, ka pasur përpjekje të shqiptarëve për krijimin e një territori autonom, i njohur si "Ilirida", por pa sukses. Forma e kësaj autonomie, me vonë e parashikua që të jetë ajo e një shteti në pjesën perëndimore të **Maqedonisë Veriore**, si njësi federale. Kjo autonomi do të ishte asimetrike, sepse ka pasur të bëj vetëm me komunitetin shqiptar. Shpallja e saj ka ndodhur dy herë, më 1992 dhe më 2014. Qeveria e **Maqedonisë së Veriut** e ka shpallur menjëherë si një projekt jokushtetues, duke mos i dhënë asnjë hapësirë për implementim. Ideja e projektit është avokuar nga politikanët lokalë shqiptarë, si një zgjidhje për shqetësimet dhe mosmarrëveshjet që komuniteti shqiptar ka pasur lidhur me njohjen kushtetuese të lirive dhe të drejtave si një pakicë kombëtare brenda **Maqedonisë së Veriut**.[70] Pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë më 1992, pozita e shqiptarëve etnikë në Maqedoninë e Veriut ishte e pasigurt.[71] **Në këtë kohë lindën parti të ndryshme politike, ndër të cilat Partia për Prosperitet Demokratik** (PPD) ishte më e njohura. Kjo parti kërkoi hapur dhe në mënyrë të ligjshme përmirësimin e statusit të shqiptarëve në **Maqedoninë e Veriut**, siç ishin të drejtat në arsim dhe përdorim të gjuhës shqipe, ndryshime kushtetuese që do të reflektonin pozitën e barabartë të shqiptarëve në shtetin e ri, lirimi i të burgosurve politik, sistemi proporcional i votimit dhe ndërprerja përgjithmonë e diskriminimit. Pakënaqësia me mungesën e njohjes kushtetuese të të drejtave kolektive të shqiptarëve rezultojë në kërkesën e z. Nevzat Halili, liderit të PPD-së, për mospranim të KMVe si të vlefshme dhe lëvizje drejt kërkesës për autonomi shqiptare në këtë vend.[72] Kjo kërkesë u pasua me një referendum, që u shpall jolegal nga autoritetet qeveritare maqedonase, që u mbajt në janar të vitit 1992. Nga qytetarët me të drejtë vote, 74% nga 92%, votuan për autonominë e shqiptarëve.[73] **Më 31 mars 1992, rreth 40000 shqiptarë demonstruan në Shkup, duke kërkuar mosnjohjen e Maqedonisë së Veriut** derisa ajo të njeh autonominë e trojeve shqiptare në këtë vend.[74] Kjo kërkesë për autonomi u ngrit në një kërkesë për republikë, e cila u shpall në Strugë në praninë e 2500 vetëve, nën organizimin e liderit të **PPD-së**, z. **Nevzat Halili**. Propozimi ka qenë që republika e re, "Ilirida", të përfshijë afërisht gjysmën e territorit të **Maqedonisë së Veriut**, kryesisht ato pjesë ku shqiptarët përbënin shumicë të konsiderueshme, në perëndim dhe veriperëndim të vendit. Si një synim përfundimtar nuk përjashtohej edhe bashkimi i shqiptarëve në ish-Jugosllavi, mirëpo, **në fund**, **qëllimi zyrtar i atyre që** shpallën republikën "Ilirida" ngeli federalizimi i **Maqedonisë së Veriut**. Autoritetet maqedonase e panë këtë si një "Kali të Trojës" dhe e refuzuan me forcë. Pozita e shqiptarëve në këtë vend u përmirësua vetëm pas luftës së armatosur të **Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare** (**UÇK**) kundër forcave të ushtrisë dhe policisë si dhe forcave paramilitare në **Maqedoninë e Veriut** dhe arritjes së **Marrëveshjes së Ohrit** (MO) me 13 gusht 2001.

---

70 Cf. Loring M. Danforth, *The Macedonian conflict: Ethnic nationalism in a transnational world*. Princeton University Press: Princeton, 1997), fq. 145; Minton F. Goldman, Minton F (1997). *Revolution and Change in Central and Eastern Europe: Political, Economic, and Social Challenges* (M.E. Sharpe: New York, 1997), fq. 324–325; Janusz Bugajski, Janusz (2016). *Ethnic Politics in Eastern Europe: A Guide to Nationality Policies, Organizations and Parties* (Routledge: London and New York, 2016), fq. 115–117.

71 Cf. Aisling Lyon, Aisling, *Decentralisation and the Management of Ethnic Conflict: Lessons from the Republic of Macedonia* (Routledge: London and New York, 2015), 32.

72 Janusz Bugajski, *Ethnic Politics in Eastern Europe,* fq. 115–117.

73 Council of Europe, *Federalism, Regionalism, Local Autonomy and Minorities: Proceedings, Cividale Del Friuli (Italy), 24-26 October 1996: Conference* (CoE Publications: Strasbourg, 1 January 1997), fq 82.

74 Židas Daskalovski, *Walking on the Edge: Consolidating Multiethnic Macedonia, 1989-2004* (Globic Press: 2006), fq. 68.

9.4. Mali i Zi

Mali i Zi asnjëherë në historinë e vet, pas shkëputjes nga unioni shtetëror me Serbinë (2006), nuk ka pasur ndonjë ide ose praktikë të autonomisë për ndonjërin prej komuniteteve që jeton në te. Për pasojë, as në **KMZi** nuk ekziston ndonjë stipulim që vë në dyshim karakterin unitar, gjerësisht të decentralizuar, të shtetit malazez. Ky decentralizim ka të bëj ekzksluzivisht me qeverisjen lokale, e cila në nenin 22 të **KMZi** garantohet si një e drejtë kushtetuese. Përkundër asaj që lejohen format tjera të vetëqeverisjes lokale, forma themelore e saj është komuna (neni 114 i **KMZi**), për çka flasim më vonë. Ajo që mund të quhet regjionalizim, ka të bëj me **nocionin jo administrativ të regjioneve** në këtë vend, sikur në vendet e tjera, që shërben për **qëllime statistikore**, përkatësisht për qëllime të **përdorimit të statistikave** të ndryshme për krijimin e parametrave matës të zhvillimit ekomomik dhe tjetër të pjesëve të caktuara të vendit.[75] E njëjta mund të thuhet edhe për **regjionet në kuptimin etnik**, të cilat krijohen nga studiuesit e ndryshëm për qëllimet e matjes dhe përcjelljes së modeleve të votimit në një vend. Këto ndarje në regjione për qëllimet e përcjelljeve të modeleve të votimit, megjithatë, nuk kanë asnjë relevancë politike ose administrative, sepse asnjë organ përfaqësues, ekzekutiv e qa më pak gjyqësor nuk ekziston në regjionet e këtij lloji: ato thjeshtë ekzistojnë si nocione për të lokalizuar **llojin dhe mënyrën e votimit** në një pjesë të caktuar të vendit.[76] Së fundi, në **aspektin ekonomik**, sikundër dihet, shtetet e ndryshme me madhësi të konsiderueshme, ndahen nëpër regjione për qëllimet e korrigjimit të shpërputhjeve në zhvillimin ekonomik mes pjesëve të caktuara të vendi. Në këtë kuptim, pra në kuptim të regjionalizimit ekonomik, **Mali i Zi** është një **mikro regjion**, pra një regjion i vetëm, që nuk ndahet në regjione të ndryshme meqë përcjellja e dispariteteve ekonomike mund të bëhet pa asnjë pengesë duke trajtuar krejt vendin si një **mikro regjion**.[77] Të gjitha këto ndarje në regjione, si të tilla, nuk kanë asnjë relevancë në të drejtën kushtetuese, por i takojnë sferës së **shkencave politike** dhe të **sociologjisë politike**.

9.5. Serbia

Shtjellimet tona për autonominë politiko-territoriale në Serbi bazohen në librin e doajenit të së drejtës kushtetuese në këtë vend, **Ratko Marković**,[78] si dhe autorë të tjerë kompetentë.[79] Bazuar në **KSerb**, Serbia hyn në radhën e shteteve unitare të decentralizuara me autonomi territoriale, i vetmi vend fqinj me Kosovën që posedon diçka të tillë. Autonomitë konsiderohen si kategori kushtetuese, pozita e të cilave normohet, përveç me **KSerb**, edhe me ligj dhe akte nënligjore. Në kategorinë e autonomive territoriale, **KSerb** fut Vojvodinën dhe Kosovën, të cilën e quan me emrin e vjetër mesjetar "Kosovë dhe Metohi". Nga aspekti kushtetues, siç do të shihet, statusi i Kosovës do të ishte i ngjashëm më atë të kohës së **Rankoviqit**, një ëndërr kjo e kahershme dhe e përhershme e shoqërisë dhe nacionalizmit serb. Sipas nenit 182 të KSerb, për Kosovën parashikohet një "autonomi substanciale", që garantohet më ligj kushtetues, i cili nuk është miratuar kurrë deri në momentin e shkrimit të këtyre rreshtave (prill 2023). Sigurisht që nuk mund të miratohet asnjëherë (sic!). Shikuar nga aspekti **rreptësisht juridik** (kushtetues dhe ndërkombëtar), marrëdhënia mes dy vendeve normohet me **marrëveshjet ndërkombëtare** të shtjelluara më sipër, të cilat janë lidhur në mënyrë sukcesive nga vitit 2011 e deri në **MO** (2023). Kjo nënkupton që në aspektin kushtetues, KSerb vlen dhe ka të bëj vetëm më Vojvodinën, kurse Kosova vazhdon të ngelet një ëndërr dhe dëshirë e nacionalizmit mesjetar serb, që e sheh atë si "tokë të shenjtë serbe".

---

75 Cf. më shumë në Jovan Radulović, "The problems of regional development in Montenegro" *Applied Studies in Agrobusiness and Commerce* Vol. 7 No. 2-3 (2013), fq. 85-88.

76 Cf. më shumë në Christina Isabel Zuber and Jelena Džankic, "Serbia and Montenegro: From Centralization to Secession and Multi-ethnic Regionalism". Në Arjan H. Schakel (ed.), *Regional and national elections in Eastern Europe: territoriality of the vote in ten countries* (Palgrave Macmillan: London, 2017), fq. 207-238.

77 Cf. më shumë në Nikola Fabris, Radokje Žugić, "Regionalisation and regional policy of Montenegro" *Journal of the Geographical Institute Jovan Cvijic* (SASA) Vol. 62 No. 1 (2912), fq. 49-67.

78 Ratko Marković, *Ustavno pravo* (Pravni fakultet Univerziteta u Beogradu: Beograd, 2016) (libri është në gjuhën serbe, alfabeti cirilik).

79 Slobodan Orlović, *Ustavno pravo* (Pravni fakultet Univerziteta u Novom Sadu: Novi Sad, 2019) (libri është në gjuhën serbe, alfabeti cirilik).

Me nenin 12 të **KSerb**, e drejta për krahinë autonome definohet si një e drejtë e qytetarëve me të cilën kufizohet pushtetit shtetëror. Kjo e drejtë e qytetarëve, përkatësisht realizimi i saj nga qytetarët në krahinë autonome i nënshtrohet kontrollit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, por jo edhe kontrollit të oportunitetit (arsyeshmërisë së ndërmarrjes së veprimeve të caktuara nga ana e organeve të autonomisë territoriale). Pra, bëhet fjalë për një të drejtë kushtetuese me të cilën bëhet decentralizimi i shtetit, e cila duhet te realizohet sipas kushtetutës dhe ligjit, gjë që kontrollohet nga organet e pushtetit qendror. Të drejtën për autonomi territoriale, qytetarët e realizojnë **në mënyrë të drejtpërdrejtë**: me iniciativë popullore, referendum dhe në zgjedhje, ose përmes përfaqësuesve të tyre kuvendin krahinor të zgjedhur lirshëm.

E drejta për autonomi krahinore realizohet në bashkësinë politiko-territoriale që krijohet me **KSerb** dhe ka statusin e **personit juridik**. Përveç Krahinës Autonome të Vojvodinë, **KSerb** parashikon mundësinë e themelimit edhe të autonomive të tjera krahinore, me karakter politiko-territorial. Propozimet për themelim të tyre duhet të vërtetohen nga qytetarët në referendum, në pajtim me ligjin, në ndërkohë që procedura për realizimin e referendumit ka karakter kushtetues (neni 182 i **KSerb**).

Çështjet tjera që normon **KSerb** lidhur me autonomitë territoriale-politike që normon **KSerb** janë: **kompetenca** dhe përkufizimi i saj; **organizimi i pushtetit**, **autonomia financiare**, **aktet juridike**, **mbikëqyrja** ndaj punës dhe **mbrojtja e autonomisë**.

Në parim, kompetencat e krahinës autonome normohen me **KSerb**, ashtu që rregullohen ato çështje me interes për krahinën në fusha të ndryshme të jetës shoqërore (neni 183 i **KSerb**). Këtu hyjnë çështjet që në mënyrë më të mirë dhe efektive mund të realizohen brenda krahinës autonome, për të cilat nuk është kompetent shteti. Kështu, ta zëmë, në vija të përgjithshme përkufizohet kompetenca e krahinës, si pushtet i ndërmjetëm i pushtetit, nga kompetenca e pushtetit shtetëror qendror dhe qeverisjes lokale, që ka të bëj me çështjet me interes republikan përkatësisht lokal. Se për cilat punë me interes republikan dhe lokal bëhet fjalë, kjo përcaktohet me ligj. Nga ky ndërtim kushtetues i përkufizimit të kompetencës mes këtyre tri niveleve të pushtetit, qartë rrjedh se nuk ekziston prezumimi i kompetencës në dobi të shtetit dhe as të autonomisë krahinore: një gjë e tillë normohet në mënyrë taksative, pra kompetencat e secilit nivel të pushtetit numërohen taksativisht dhe asgjë nuk prezumohet në favor të askujt. Me fjalë të tjera, **KSerb** kufizon kompetencën e autonomisë duke përcaktuar fushat që përmbajnë punë dhe çështje me interes për krahinën autonome: planifikimi dhe zhvillimi hapësinor, bujqësia, ekonomia ujore, pylltaria, gjuetia, peshkimi, turizmi, hoteleria dhe qendrat për shërim, mbrojtja ambientit jetësor, komunikacioni rrugor, hekurudhor dhe në lumenj dhe rregullimi i rrugëve, organizimi i panaireve dhe manifestimeve të tjera ekonomike, arsimi, sporti, kultura, mbrojtja sociale dhe shëndetësore dhe informimi publik në nivel të krahinës, krejt kjo në pajtim me ligjin. Përkundër që këto kompetenca janë të përcaktuara me **KSerb** dhe mund të konsiderohen si **kompetenca burimore**, konkretizimi i tyre, përkatësisht përcaktimi çështjeve dhe punëve të ngushta, konkrete, normohet me ligj. Kjo nënkupton që shteti, praktikisht, me ligj ia beson punët krahinës autonome dhe, për pasojë, me ligj edhe mund t'i merr prapa. Si **kompetenca të pastra burimore** ngelen vetëm dy: organizimi i pushtetit krahinor dhe konformimi i simboleve krahinore, stemës dhe flamurit, dhe mënyra e përdorimit të tyre.

Organizimi i pushtetit krahinor si kompetencë burimore nënkupton që një të drejtë të krahinës për të rregulluar kompetencën, zgjedhjen, organizimin dhe punën e organeve dhe shërbimeve publike që vet i themelon. Ajo këtë e bën në pajtim me KSerb dhe statutin e saj, jo në pajtim me ligjin. KSerb vetëm përcakton se **kuvendi** i është **organi më i lartë të krahinës autonome**, të cilën e përbëjnë deputetët që zgjeshen për katër vite në zgjedhje të drejtpërdrejta, me votim të fshehtë, konform vendimit të kuvendit të krahinës (neni 180 i **KSerb**). Me KSerb përcaktohet gjithashtu që përfaqësimi i pakicave kombëtare duhet të jetë proporcional.

KSerb njeh **autonominë financiare** të autonomisë krahinore, ashtu që i garanton asaj të ardhura burimore me të cilat financohen kompetencat e saj. Me ligj përcaktohen se cilat janë ato të ardhura, një pjesë e tatimeve shtetërore, taksa, si dhe cila është shuma e tyre. Në të njëjtën kohë, me ligj caktohet edhe pjesëmarrja e krahinës në buxhetin e shtetit, mënyra dhe niveli i pjesëmarrjes.

Krahina autonome miraton aktet e saj të përgjithshme, mirëpo **nuk ka kompetencë ligjvënëse**. Kjo nënkupton që statuti i saj, si akti më i lartë, ka fuqinë juridike të aktit nënligjor. Statuti, vendimet dhe aktet tjera të përgjithshme krahinore duhet të jenë në harmoni reciproke dhe në pajtim me kushtetutën e ligjin. Specifika e **statutit krahinor** konsiston në atë se, **në procedurën e miratimit të tij**, marrin pjesë dy organe: kuvendi krahinor që miraton atë dhe Kuvendi i Republikës që jep pëlqimin paraprak për draftin e statutit të propozuar.

Në rregullimin e autonomisë krahinore, KSerb ia ka lënë pushtetit qendror të drejtën për kontroll të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërinë ndaj krahinës. Kjo e drejtë me KSerb konkretizohet në dy mënyra. Së pari, qeveria serbe ka të drejtën e nisjes së procedurës për vlerësim të kushtetutshmërisë ose ligjshmërisë së vendimit krahinor para hyrjes së saj në fuqi. Në një rast të tillë, gjykata mund të shtyje hyrjen në fuqi të vendimit krahinor deri në vendosjen mbi kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e tij (neni 186 i KSerb). Mënyra e dytë është kur organi tjetër shtetëror, si: qeveria, gjykata, prokuroria publike, presidenti i Serbisë, Kuvendi Serbisë, ose **Gjykata Kushtetuese** (GJKSerb), inicion procedurën për vlerësimin e kushtetutshmërisë ose të ligjshmërisë së dispozitave krahinore. Në një rast të tillë, shteti të drejtën e vet të mbikëqyrjes së autonomisë e realizon përmes vendimit të **GJKSerb** mbi kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e aktit të krahinës autonome.

GJKSerb ka kompetencë për **mbrojtjen e autonomisë së krahinës**, gjithashtu në dy mënyra (neni 187 i KSerb). Kur me akt ose veprim individual të organit shtetëror ose lokal, krahinës i pamundësohet ushtrimi i kompetencave të saj, atëherë organi i saj (qeveria ose kuvendi krahinor) ka të drejtën e ankesës kushtetues në **GJKSerb**. Mënyra e dytë ka të bëj me aktet e përgjithshme me të cilat cenohet (shkelet) e drejta për autonomi krahinore. Në një rast të tillë, organi krahinor ka të drejtë të vejë në lëvizje procedurën për vlerësimit të kushtetutshmërisë ose të ligjshmërisë së ligjit të tillë ose të aktit tjetër republikan, përkatësisht krahinor.

10. Vetëqeverisja lokale

10.1. Kuptimi dhe lindja e vetëqeverisjes lokale

Vetëqeverisja lokale është niveli më i afërm i pushtetit me qytetarin. Në nivelin lokal ekzistojnë mundësitë më të shumta për demokracinë e drejtpërdrejtë dhe pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të qytetarëve në pushtet. Është një formë vertikale e organizimit të pushtetit që formohen në bashkësinë lokale, si njësia më e imët e territorit shtetëror, me të cilën qytetarët udhëheqin përmes organeve të zgjedhura dhe drejtpërdrejtë. Kjo nënkupton të drejtën e vendimmarrjes politike dhe një shkallë të caktuar të lirisë në raport me pushtetin qendror, por edhe në raport me nivelin e ndërmjetëm të pushtetit aty ku ai ekziston (në njësitë federale dhe autonomitë territoriale).

E drejta për vendosje politike në njësinë e vetëqeverisjes lokale nënkupton që në te nuk kryhen vetëm punët komunale dhe bëhet ekzekutimi i akteve të pushteteve më të larta, por ekziston një shkallë e lartë "qeverisjes së vetvetes" nga qytetarët dhe organet lokale. Vetëqeverisja lokale nënkupton një situatë të atillë juridike në të cilën qytetarët përmes organeve lokale ose drejtpërdrejtë, në bazë të kushtetutës dhe ligjit, marrin vendime politike dhe miratojnë akte që kanë rëndësi për bashkësinë lokale. Brenda kësaj bashkësie lokale ekzistojnë, krahas **marrëdhënieve juridike**, edhe marrëdhëniet politike mes vetë organeve lokale dhe mes qytetarëve dhe organeve lokale. Marrëdhënia reciproke mes organeve lokale vendoset përmes formave të **bashkëpunimit**, **kontrollit**,

baraspeshës dhe **përgjegjësisë reciproke**, konform parimit të ndarjes ose unitetit të pushtetit. Ana tjetër e **vetëqeverisjes politike** lidhet me deklarimin dhe vendosjen e qytetarëve në **referendumin lokal**, si dhe lidhur me **zgjedhjen dhe shkarkimin** e organeve të pushtetit lokal. Për shtetin bashkëkohor dhe ndarjen vertikale të pushtetit në te, megjithatë, drejtimi politikisht i pavarur i bashkësisë lokale, në nivel të një qeverie për vetveten, paraqitet si një kuptim i tejkaluar. Liria e komunitetit vendor definohet me aktet e pushtetit qendror, kontrollohet përmes të drejtës së mbikëqyrjes. Në aspektin politik, kjo liri kufizohet edhe nga aktiviteti i partive të mëdha në nivel lokal. Për këtë arsye nuk është jo e saktë nëse thuhet se **vetëqeverisja lokale** është kategori e prejardhur nga pushtetit shtetëror, që është subjekt i të drejtës publike dhe private njëkohësisht, përkatësisht një **krijesë shtetërore vetëqeverisëse** në të cilën **shteti në mënyrë sovrane**, rregullon statusin, organizimin dhe funksionimin e saj.

Krahas vetëqeverisjes lokale, për komunitetin apo bashkësinë lokale përdoren edhe emërtime të tjera, siç janë: **administrata lokale**, **autonomia lokale**, **administrimi lokal**, **demokracia komunale**, **qeverisja lokale**, **vetëqeverisja lokale**. Disa nga këto shprehje, siç janë administrata lokale dhe administrimi lokal, kanë vetëm kuptim administrativ, kurse shprehjet tjera si vetëqeverisja lokale, demokracia komunale dhe qeverisja lokale kanë kuptim politik. Ndryshe, shprehjen "vetëqeverisja lokale" ("local self-government") për herë të parë e ka përdorur filozofi anglez **Xheremi Bentam** (Jeremy Bentham: 1747-1832) në gjysmën e parë të shek. XIX, kurse **Aleks de Tokvil** (Alexis de Tocquueville: 1805-1859) më vonë ka vërejtur se "në komuna qëndron fuqia e popujve të lirë".[80] Në aspektin përmbajtësor, shprehja shqip "vetëqeverisje lokale" përputhet me shprehjen që përdoret në Zvicër si "autonomie locale" dhe shprehjen gjermane "gemeinde (kommunal) selbstverëaltung". Shprehja franceze "administration locale" është më e ngushtë, kurse më të gjëra janë shprehjet angleze "local government" dhe "local self-government".

Një formë e vetëqeverisjes lokale ka ekzistuar në organizimin e bashkëjetesës në bashkësitë e hershme lokale te popujt e paorganizuar në bashkësi politike shtetërore. Populsia vendore, me vetiniciativë, nga gjiri i vetë ka zgjedhur gjyqtarët që kanë gjykuar kontestet reciproke dhe veprat e ndëshkueshme, si dhe bashkëkombësit që janë përkujdesur për interesat dhe punët e përbashkëta. Zhvillimi vërtetë i vetëqeverisjes lokale lidhet me proceset e urbanizimit të shpejt, me krijimin dhe zhvillimin e shteteve, që ka nënkuptuar edhe **deagrarizimin** shkallë-shkallë të shtetit. Pranimi i të drejtës për vetëqeverisje lokale nis në Angli, Gjermani, Suedi etj., në shek. XII, me lindjen e **klasës së re borgjeze**, kurse zhvillohet pas shkatërrimit të feudalizmit dhe monarkisë absolute.[81] Mënyra e re dhe e pavarur e udhëheqjes me bashkësinë apo komunitetin lokal dhe punët e përbashkëta lidhet me territorin e ngushtë të qytetit. Në qytetet mesjetare lind ndarja e re e punës dhe mënyrë e ndryshme e bashkëjetesës që organizohet në hapësira relativisht të vogla. Në qytete zhvillohet tregtia dhe zejet, krijohet vetëdija politike e qytetarëve, të cilët bëhen qendra e luftës për të drejta të njeriut dhe burim i pikëpamjeve të reja mbi botën. Duke fituar kartat ("charters", që kanë kuptimin e **lejeve**/**licencave**) nga pushtetet më të larta (mbretërit dhe feudalët), qytetet fituan privilegjin për organizim të pavarur të ndarjes së punëve të përditshme, për

[80] Cf. më shumë në Slobodan Orlovic, "Ustavnopravni polozaj lokalne samouprave u Srbiji". *Zbornik radova Pravnog fakulteta u Novom Sadu* 4 (2015), fq. 1649-1667 në fq. 1652 (shkrimi është vetëm në alfabetin cirilik).

[81] Për një trajtim të shkëlqyer të kësja tematike, cf. më shumë në Jonathan Doucette. *The Roots of Urban Self-Government* (PhD Dissertation). Submitted August 31, 2020. The public defense took place in November 6, 2020, published November 2020. Department of Political Science. Aarhus BSS, Aarhus University. Në internet: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://politica.dk/fileadmin/politica/Dokumenter/Afhandlinger/doucette.pdf (shikuar më 8 prill 2023). Më pastaj, në mesin e shek. XIX dhe fillim të shek. XX, kjo shprehje dhe praktika e bazuar në te u bart në vendet Aziatike përmes pushtimeve koloniale. Cf. më shumë në Donglan Huang, "The Concept of "Self-Government" across Cultures: From the Western World to Japan and China". *Cultura. International Journal of Philosophy of Culture and Axiology* Vol. 15 No. 2 (2018), fq. 53-72 (autori përshkruan edhe lindjen e nocionit dhe praktikës së vetëqeverisjes në kulturën perëndimore, në kontekstin e urbanizimit të shpejt dhe deagrarizimit të shteteve të zhvilluara të Evropës, dhe bartjen e kësaj praktike në pjesët tjera të botës përmes rrugëve koloniale).

të bërë organizimin e pushtetit. Për më tepër, ato fitojnë të drejtën për të organizuar mbrojtjen e tyre vetjake, ushtrinë, me detyrimin që, si tërësi, të paguajnë tatimin. Me kalimin e kohës, një rend i tillë ndër qytete, çdo ditë e më shumë dallon nga rendi feudal të pjesës tjetër të qytetit.

Me rritjen e qyteteve, lindi edhe çështja e madhësisë së njësisë së vetëqeverisjes lokale. A të organizohen ato si njësi të mëdha ose të vogla, në mënyrë që më pastaj të shpinte në ndarjen e qyteteve të mëdha ose bashkimin e më shumë vendbanimeve, fshatrave, në një njësi vetëqeverisëse. Njësitë më të vogla vendore janë më të përshtatshme për realizimin e demokracisë së drejtpërdrejtë dhe vetëqeverisjes, por çfarë madhësie do të jenë ato varet nga pushteti qendror. Shteti ndan **me ligj** territorin në njësi të vetëqeverisjes lokale, duke marrë parasysh **kritere të ndryshme**. Ato kritere mund të jenë: tradita, lidhja ekonomike dhe e biznesit e territorit vendor, kriteri i përkatësisë nacionale të popullsisë vendore (pak më rrallë merret parasysh), kërkesat dhe dëshirat e popullsisë vendore. Me rastin e themelimit të njësisë së vetëqeverisjes lokale dhe ndryshimit të kufijve të saj, pushteti qendror duhet të konsultoj komunitetin vendor, ndoshta edhe me referendum, siç e kërkon neni 5 i **Karta Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale** (KEVL) e vitit 1985, kurse deklarimi i qytetarëve vetëm përjashtimisht ka karakter të detyrueshëm.

10.2. Marrëdhëniet me pushtetin qendror dhe realizimi demokratik i vetëqeverisjes lokale

Vetëqeverisja lokale kufizon juridiksionin dhe kompetencën e organeve të pushtetit qendror në aspektin e **gjerësisë**, përkatësisht në bazë të punëve që kryen në mënyrë burimore, si dhe në aspektin e **thellësisë**, përmes kryerjes së punëve konkrete të komunitetit që drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me përditshmërinë e qytetarëve. Kështu, ta zëmë, nëse në nivel shtetëror parashihet detyrimi i furnizimit me ujë të qytetarëve, atëherë i lihet nivelit lokal konstatimi dhe realizimi i këtij detyrimi shtetëror. Vetëqeverisja lokale kufizon pushtetin qendror ashtu që përcakton dhe zbaton politikën lokale-planifikon dhe përcakton qëllimet e aktivitetet në nivel vendor, miraton strategjinë e zhvillimit, miraton dhe zbaton dispozitat juridike vendore.

Përkufizimi i punëve mes pushteti qendror dhe vetëqeverisjes lokale mund të jetë i **përgjithshëm** dhe **konkret**. Përkufizimi **në mënyrë të përgjithshme** bëhet në atë mënyrë që përcaktohet se punë vendore janë ato që nuk kryhen nga pushteti qendror, dhe të cilat ndikojnë në zhvillimin e komunitetit vendor dhe jetën e qytetarëve të tij. Përkufizimi i tillë bëhet duke përdorur shprehej si vijon: punët komunale ose të komunitetit, çështjet me rëndësi lokale (vendore) në fushat e numëruara, dhe njësia e vetëqeverisjes lokale kryen praktikisht të gjitha punët përveç atyre që shprehimisht nuk bien në juridiksion dhe kompetencë të pushteti qendror dhe niveleve të tjera të pushtetit. Përkufizimi **në mënyrë konkrete** bëhet ashtu që punët e vetëqeverisjes lokale bëhen përmes enumeracionit taksativ të tyre. Këtu me kushtetutë ose ligj numërohen kompetencat dhe juridiksioni i vetëqeverisjes lokale, të cilat më pastaj konkretizohen me akte nënligjore të nivelit lokal. Çdo gjë që ngelet jashtë kompetencave të numëruar dhe juridiksionit kryhet nga nivele të tjera të pushtetit.

Bazuar në kriterin e pavarësisë së vetëqeverisjes lokale nga pushtetit qendror, dallohet **tri modele organizative**. Modeli i parë është ai i **pavarësisë së plotë** të vetëqeverisjes lokale. Ky sot është një koncept i rrallë dhe nënkupton organizimin e komunës si njësi politike, sipas modelit të **Komunës së Parisit** të vitit 1871, e cila praktikisht, njëjtë sikur shteti, do të kishte të gjitha organet e pushtetit. Në të do të ekzistonte organi përfaqësues, që miraton ligjet lokale - aktet normative. Krahas tij do të ekzistonin edhe organi i pushtetit ekzekutiv, qeveria, dhe gjykatat lokale që zgjidhen nga kuvendet ose nga qytetarët. Modeli i dytë është ai i **varësisë së plotë** të vetëqeverisjes lokale, në të cilin ajo ka vetëm ato kompetenca që ia beson pushteti qendror, i cili, në të njëjtën kohë, ruan për vete të drejtën e kontrollit të ligjshmërisë dhe oportunitetit të punës dhe akteve të nxjerra nga organet lokale. Ky model është karakteristikë e shtetit të centralizuar, në të cilin nuk ka vetëqeverisje në nivel lokal. Së fundit, **modeli i përzier** i vetëqeverisjes lokale, i cili është më i përhapuri, kombinon punët burimore dhe të besuara të

cilat kryhen në nivel lokal. Në këtë rast, organet lokale kryesisht janë të pavarura sepse mbizotërojnë punët (kompetencat) burimore, kurse në një masë më të vogël, kryerja e punëve të besuara i nënshtrohet kontrollit të tërësishëm të pushtetit qendror.

Në aspektin teorik, vetëqeverisja lokale do të duhej të ishte në nivelin më të lartë të realizimit të demokracisë, sikur qytetarët të vendosnin në mënyrë të drejtpërdrejtë për punët e rëndësisë lokale. Edhe pse për një gjë të tillë ekzistojnë kushtet, për shkak të hapësirës së vogël dhe numrit të qytetarëve në raport me shtetin si tërësi, në vetëqeverisjen lokale, megjithatë, vendoset përmes organeve të zgjedhura lokale. Në këtë ndikojnë faktorët, siç janë, rritja e vëllimit të punëve të vetëqeverisjes lokale dhe specifikimi i tyre, që kërkon vendimmarrje të vazhdueshme, kualifikime profesionale dhe njohuri të veçanta praktike. Banorët e vetëqeverisjes lokale, këto cilësi zakonisht nuk i posedojnë. Për këtë arsye për realizimin e vetëqeverisjes lokale, rëndësi kanë cilësia dhe aftësia e përfaqësuesve të banorëve lokalë për kryerjen e punëve që kanë rëndësi për jetën e tyre në nivel lokal.

Në realizimin e vetëqeverisjes në nivel të komunitetit, në mënyrë negative ndikon zgjerimi dhe forcimi i rolit të shtetit bashkëkohor. Shteti i sotëm ka zhvilluar rregullativë unike juridike për krejt territorin shtetëror dhe merr mbi vete kryerjen edhe të punëve lokale. Përpjekjet e **shtetit bashkëkohor të mirëqenies** ("Welfare state") që synon plotësimin e nevojave të qytetarëve përmes sistemit shtetëror të shërbimeve publike në shëndetësi, arsim, komunikacion dhe fusha të tjera, kanë shtyrë në plan të dytë kërkesën dhe nevojën për vetëqeverisje lokale. Kjo nënkupton, në mënyrë automatike, ngushtim të pavarësisë normative dhe financiare të vetëqeverisjes lokale.

Realizimi i vetëqeverisjes lokale dhe demokracisë së saj varet nga mënyra e zgjedhjes së organeve lokale të pushtetit. Organet lokale, përkatësisht kryetari komunës, këshilli, kuvendi, kanë lidhje më të afërta me banorët lokal nëse ata i kanë zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë. Pyetja që shtrohet është kjo: kënd zgjedhin ata dhe sipas cilit kriter? Marrë parasysh se në nivel lokal nuk zhvillohet politika e lartë shtetërore por zgjidhen problemet jetësore të përditshme të qytetarëve, në organet lokale duhet zgjedhur kandidatët që, të prirë nga interesat lokale, zgjedhin problemet lokale. Kjo shkon në favor të demokratizimit të vetëqeverisjes lokale. Me organizimin e dendur dhe të strukturuar në nivel lokal, aktivitetin dhe ndikimin që shtrijnë, partitë e mëdha sot dominojnë edhe komunitetet lokale përmes caktimit të kandidatëve partiak për postet kryesore në organet lokale. Me këtë, interesat lokale efektivisht definohen nga interesat partiake.

10.3. Llojet dhe format e vetëqeverisjes lokale

Për llojet dhe format e vetëqeverisjes lokale mund të bëhet fjalë **vetëm në rastet e shteteve të decentralizuara**, në të cilat ekzistojnë organe të posaçme të pushtetit që janë të pavarura në raport me organet qendrore. Në shtetin e centralizuar, ndërkaq, mohohet ekzistimi i llojeve dhe formave të vetëqeverisjes lokale, për arsye se organet vendore janë pa kompetenca të pavarura dhe burimore.

Vetëqeverisjen lokale mund ta ndajmë në dy sisteme të mëdha: **në sistemin e njëllojtë** dhe **në sistemin me shumë lloje**. Në sistemin e parë, **sistemin e njëllojtë**, ekziston vetëm një lloj i vetëqeverisjes lokale në krejt territorin shtetëror. Në këtë sistem, njësitë e vetëqeverisjes lokale janë uniforme, me organe të njëjta të pushtetit dhe kompetenca. Këtu futet edhe vetëqeverisja lokale në të cilën njihet lloji themelor i saj, në ndërkohë që të tjerat lloje janë modele të nxjerra që dallohen vetëm sa i përket madhësisë dhe disa detaje sa i përket organizimit të pushtetit dhe kompetencës. Kështu do të ishte rasti, ta zëmë, kur komuna dhe qyteti i madh do të formonin sistemin e njëllojtë të vetëqeverisjes lokale, nëse kanë organe dhe kompetenca të njëjta.

Në sistemin tjetër, në **sistemin me shumë lloje**, ekzistojnë disa lloje të vetëqeverisjes lokale. Ky sistem është më fleksibil sepse ekziston mundësia që organizimi dhe kompetencat e vetëqeverisjes lo-

kale të përshtaten me kushtet dhe rrethanat e veçanta që karakterizojnë komunitetin përkatës lokal, siç janë: madhësia, relievi, niveli i zhvillimit ekonomik, nevojat e popullsive vendore etj. Duke marrë për bazë këto karakteristika, në një sistem politik mund të ekzistojnë njëkohësisht këto trajta të qeverisjes lokale:

- njësia vetëqeverisjes lokale me kuvendin si organ përfaqësues, qeverinë lokale, përkatësisht me këshillin dhe kryetarin e njësisë së vetëqeverisjes lokale, të cilin e zgjedhin qytetarët ose zgjidhet në mënyrë të tërthortë (ky është standardi më i përhapur në vendet ish-komuniste të Evropës dhe në vendet tjera të demokracive tradicionale në Evropë);
- vetëqeverisja lokale me kryetarin/prefektin që zgjidhet drejtpërdrejtë nga votuesit për të shërbyer si shef i ekzekutivit, dhe me këshillin e zgjedhur drejtpërdrejtë; ky sistem ka dy forma, në vartësi të pushtetit që ka kryetari/prefekti në raport me këshillin: në formën e parë, kryetari/prefekti i zgjedhur ka gati krejt pushtetit administrativ, përfshirë të drejtën për caktimin dhe shkarkimin e shefave të departamenteve; në këtë sistem, stafi administrativ i kryetarit/prefektit përgatitë buxhetin e qytetit, ani pse zakonisht ai duhet të miratohen nga këshilli qytetit; në formën e dytë, kryetari/prefekti nuk ka autoritet formal jashtë këshillit, duke shërbyer kryesisht si kryesues i këshillit me funksion ceremonial, pa të drejtën e caktimit ose shkarkimit të zyrtarëve lokal, ose të drejtën e vetos kundrejt vendimeve të këshillit (të tilla janë rastet në **Brazil**, **Itali**, **Izrael**, **Kanada, Poloni, SHBA**, **Turqi**, **Zelandë e Re**, në të cilat ekziston vetëqeverisja këshill-prefekt, **mayor-council government**);[82]
- njësia e vetëqeverisjes lokale që përbëhet nga një organ i vetëm kolegjial, komisioni, i cili zgjidhet drejtpërdrejtë, përbëhet nga disa anëtarë (zakonisht prej pesë anëtarëve) dhe kryen funksionin normativ dhe ekzekutiv; komisionerët këtu formojnë trupin ligjvënës të qytetit dhe, si grup, janë përgjegjës për taksat, përvetësimet, urdhëresat, dhe funksione të tjera publike; ata gjithashtu kanë funksione ekzekutive për aspektet specifike të punëve të bashkësisë vendore, siç janë: punët publike, financat, siguria publike; në këtë formë të qeverisjes, pra, përzihen dega legjislative dhe ekzekutive në të njëjtin trup; njëra nga komisionerët mund të caktohet për të shërbyer si prefekt, por gjerësisht ka rol honorifik ose ceremonial (të tilla janë rastet në disa shtete në SHBA, të njohura si qeverisjen e qytetit me komision, **city-commission government**);[83]
- njësia e vetëqeverisjes lokale me një menaxher që me kontratë angazhohet nga këshilli lokal, i cili, me pagesë dhe për periudhën e kontraktuar, drejton njësinë e vetëqeverisjes lokale, në mënyrë të ngjashme me subjektet ekonomik (të tilla janë raste në Irlandë, SHBA, me vetëqeverisjen këshill-menaxher, **council-manager government**). Në këtë sistem bëhet kombinimi i lidershipit të fortë të zyrtarëve të zgjedhur në këshill ose trup tjetër qeverisës me përvojën e fortë menaxheriale të një menaxheri në nivel lokal të qeverisjes. Kjo formë ndërton një sistem përfaqësimi, në të cilin krejt pushteti koncentrohet në këshillin e zgjedhur, i cili, në anën tjetër, kontrakton një menaxher të trajnuar për të mbikëqyrur dhënien e shërbimeve publike. [84]

---

[82] Cf. më shumë në Richard C. Feiock, Moon-Gi Jeong and Jaehoon Kim, "Credible Commitment and Council-Manager Government: Implications for Policy Instrument Choices". *Public Administration Review* Vol. 63 No. 5 (Sep. - Oct., 2003), fq. 616-625; Jered B. Carr, "What Have We Learned about the Performance of Council-Manager Government? A Review and Synthesis of the Research" *Public Administration Review* Vol. 75 No. 5 (September/ October 2015), fq. 673-689.

[83] Për aspektin historik dhe aktual të këtij lloji të vetëqeverisjes lokale, që ka nisur kryesisht në jug të SHBA-ve, cf. më shumë në William O. Scroggs, "Commission Government in the South". *The ANNALS of the American Academy of Political and Social Science* Vol. 38 No. 3 (1911), fq. 12-27; Seth M. Scheiner, "Commission Government in the Progressive Era: The New Brunswick, New Jersey, Example". *Journal of Urban History* Vol. 12 No. 2 (1986), fq. 157-179; Lynette B. Wrenn, "Commission Government in the Gilded Age: The Memphis Plan" *Tennessee Historical Quarterly* Vol. 47, No. 4 (Winter 1988), fq. 216-226.

[84] William A. Sommers, "Council-Manager Government: a Review". *Western Political Quarterly* Vol. 11 No.1 (1958), fq. 137–148; James H. Svara, "The Shifting Boundary between Elected Officials and City Managers in Large Council-Manager Cities" *Public Administration Review* Vol. 59 No. 1 (Jan. - Feb., 1999), fq. 44-53; James H.

Sistemi vetëqeverisjes lokale mund të dallohet sipas numrit apo niveleve të pushtetit lokal. Bëhet fjalë për vetëqeverisje lokale **njëshkallëshe** atëherë kur ekziston vetëm një nivel i pushtetit lokal (Austria, Sllovenia, Zvicra etj). Kjo nënkupton se këtu ekzistojnë organet qendrore dhe lokale, kurse nëse në shtet ekziston edhe niveli i mesëm i pushtetit ai nuk i takon sistemit të vetëqeverisjes lokale, por autonomisë territoriale. Në këtë sistem, në nivel të njëjtë të pushtetit janë të gjitha nivelet kompetencat lokale, burimore dhe të bartura.[85]

Sistemi dyshkallësh i vetëqeverisjes lokale ka dy nivele të pushtetit (Çekia, Holanda, Norvegjia, Suedia, SHBA-ja). Niveli i dytë përfshinë më shumë vetëqeverisje lokale të nivelit të parë. Në dy nivele, ta zëmë në komunë, rreth, regjion etj., kryhen punët burimore dhe të bartura, mirëpo niveli i dytë ka të drejtën e mbikëqyrjes, marrjes së vendimit në shkallë të dytë si dhe të drejtën e planifikimit.

Sistemi treshkallësh i vetëqeverisjes lokale është më i komplikuari dhe strukturalisht më i zhvilluari (Franca, Italia, Spanja). Këtu kompetenca e vetëqeverisjes lokale ndahet në tri nivele të pushtetit, mes të cilëve ekziston një raport bashkëpunimi dhe i hierarkisë - ta zëmë, komuna, departamenti, rrethi, qarku, regjioni. Niveli i tretë është njësia më e madhe dhe përfshinë më shumë njësi vetëqeverisëse të nivelit të dytë. Në nivelin e parë, që është më së afërmi me qytetarin, kryhet pjesa më e madhe e punëve të komunitetit. Pushteti lokal në dy nivelet tjera kryen punët që kërkojnë planifikim më të gjerë, investime më të mëdha në infrastrukturë, ta zëmë: në komunikime, zona ekonomike, mbrojtjen e gjithanshme të ambientit jetësor, vendimmarrjen në shkallë të dytë, mbikëqyrjen inspektive.

Sistemi joformal i vetëqeverisjes lokale lind me lidhjen e vetëqeverisjeve lokale. Bëhet fjalë për të drejtën e asociimit, "motërzimit"/"vëllazërimit", mes njësive të vetëqeverisjes lokale brenda ose jashtë shtetit (twin towns, sister cities). Qëllimi i lidhjes së tillë dypalëshe dhe shumëpalëshe mund të jetë i përgjithshëm, siç është bashkëpunimi kulturor, ndihma reciproke, këmbimi informatave, ose realizimi i ndonjë interesi ose punë konkrete. Me asociim nuk ndryshon sistemi i rregulluar i njësive e bashkësive lokale, sepse ai përbën një nga mundësitë që rrjedh nga parimi i pavarësisë së vetëqeverisjes lokale.

10.4. Organizimi i pushtetit në vetëqeverisjen lokale

Organizimi i pushtetit në njësinë themelore të vetëqeverisjes lokale përbëhet nga **organi përfaqësues**, **organi ekzekutiv** dhe **administrata**. Për shkak se pushteti lokal është më së afërmi me qytetarin, mekanizmi i marrjes së vendimeve (vendimmarrja) duhet të jetë hapur dhe i qasshëm për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të popullsisë lokale. Kahet e zhvillimit të vetëqeverisjes lokale tregojnë për atë që organizimi i pushtetit lokal do të jetë më i ndërlikuar në raport me gjendjen që është sot në vendet bashkëkohore, nga shkaku se përfshinë çdo ditë e më shumë, krahas sektorit publik, edhe sektorin privat. Duket qartë aktualisht se ky sektor, sektori privat, çdo ditë e më shumë do të involvohet në ofrimin e shërbimeve publike.

Organi përfaqësues është trupa normative që sjell (miraton) dispozitat lokale, në rend të parë statutin si aktin më të lartë juridik, si dhe aktet tjera të përgjithshme. Trupi përfaqësues është i organizuar si kuvend ose parlament lokal, i përbërë nga anëtarët të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë i zgjedhin vetë qytetarët,

Svara, "Effective Mayoral Leadership in Council-Manager Cities: Reassessing the Facilitative Model" *National Civic Review* Vol. 92 No. 2 (Summer 2003), fq. 157-172.

85 Cf. më shumë në Alan Norton, *Local Government in Other Western Democracies. Introductory Paper No 4*. Në Institute of Local Government Studies (University of Birmingham: Birmingham, 1985); Alan Norton, "West European Local Government in Comparative Perspective". Në Richard Batley and Gerry Stoker (eds.), *Local Government in Europe. Trends and Developments* (Macmillan: Houndsmills, 1991), fq. 21–40. Alan Norton, *International Handbook of Local and Regional Government. A Comparative Analysis of Advanced Democracies*. (Edward Elgar: Aldershot, 1994); Alan Norton, "What East European Democracies Might Learn from the West". Në Andrew Coulson (ed.), *Local Government in Eastern Europe. Establishing Democracy at the Grassroots* (Edward Elgar: Aldershot, 1995), fq. 264–280.

sot me votim të fshehtë, dikur përmes tubimeve publike. Anëtarët, që zakonisht quhen këshilltar, janë përfaqësues të partive politike, shoqatave të qytetarëve ose të pavarur. Me kuvendin udhëheq kryetari, i cili në disa sisteme njëkohësisht është edhe në krye të njësisë vetëqeverisëse. Organi përfaqësues mund të jetë më i vogël se kuvendi, në formë të këshillit të qytetit, anëtarët e të cilit gjithashtu zgjedhën në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët. Funksionin e trupit përfaqësues në shtetet ku ekziston më shumë demokraci e drejtpërdrejtë, mund ta luajnë vetë qytetarët e mbledhur nëpër tubime, në të cilat vendimet merren me **aklamacion**.

Organet ekzekutive lokale drejtojnë, njëjtë sikur ekzekutivi qendror, njësinë e vetëqeverisjes lokale, duke përgatitur aktet që i miraton organi lokal përfaqësues si dhe duke miratuar aktet e vendimet e organit lokal përfaqësues dhe ato të nivelit qendror të pushtetit. Funksionin ekzekutiv në njësinë e vetëqeverisjes lokale mund ta kryejnë një ose dy organe, më rrallë disa syresh. Njëri organ është kolektiv: këshilli (pleqësia, bordi), i cili, në vija të përgjithshme, është sikur qeveria në nivel qendror. Ai përbëhet nga anëtarët, që janë të ngarkuar për fusha ose shërbime të caktuara, dhe nga kryetari. Ky mund të jetë njëkohësisht edhe kryetar i njësisë vetëqeverisëse dhe, në këtë rast, bëhet fjala për **funksionin ekzekutiv monocefal** (kryetari shërben si shef i ekzekutivit lokal dhe i organit përfaqësues). Krahas këshillit (pleqësisë, bordit), funksionin ekzekutiv mund ta ushtroj edhe udhëheqësi i bashkësisë vendore: kryetari (prefekti, guvernatori). Krahasuar me nivelin shtetëror, kjo pozitë më së shumti ngjan me rolin dhe pozitën kushtetuese të shefit të shtetit. Kryetari i një njësive vetëqeverisëse mund të jetë shef i këshillit (pleqësisë, bordit), më rrallë kryetar komune ose ndonjë funksionar ndividual i posaçëm. Ai zgjidhet drejtpërdrejtë nga qytetarët, që nënkupton se ka legjitimitet më të fortë dhe pozitë më të mirë, por mund të zgjidhet edhe nga kuvendi ose këshilli (pleqësia, bordi), që do të thotë se pozita në fjalë është më e dobët. Bartësi i funksionit ekzekutiv në njësinë e vetëqeverisjes lokale mund të jetë edhe menaxher. Atë e zgjedh organi komunal, zakonisht në bazë të një konkursi publik të realizuar, bazuar në kriteret profesionale. Në këtë rast funksioni ekzekutiv nuk është politik por profesional.

Administrata lokale ekziston në çdo njësi vetëqeverisëse. Nga madhësia dhe numri i punëve burimore dhe të bartura varet struktura, numri dhe vëllimi i punëve të administratës lokale. Ajo mund të ndahet (strukturohet) në disa pjesë organizative, sipas llojit të punës që kryen: administrata për tokë, rrugë, arsim, ndihmë juridike, avokati publike dhe inspeksion. Administrata përbëhet nga njerëz profesionistë, të zgjedhur sipas kualifikimeve profesionale, që i ofrojnë shërbime qytetarëve. Rregullat mbi mbikëqyrjen e administratës shtetërore vlejnë kryesisht edhe për administratën lokale.

Përveç organizimit si më sipër, si rezultat i nevojave konkrete të vetëqeverisjes mund të ekzistojnë edhe organet tjera lokale, si organe të posaçme, por me kusht që të jenë të përcaktuara me ligj ose statut. Kështu ekzistojnë, ta zëmë, zyra e avokatit lokal të popullit, këshilli nacional, menaxheri financiar, arkitekti etj.

Nuk do mend për të kuptuar se qytetarët nuk janë organ i vetëqeverisjes lokale, mirëpo ndikimi i tyre është shumë më i madh sesa në nivelin shtetëror. Gravitimi i qytetarëve në pushtetin lokal bën që ata më shpesh të marrin pjesë në prurjen e vendimeve dhe të propozojnë miratimin e dispozitave përmes iniciativës qytetare. Numri i duhur i qytetarëve për nisjen e procedurës për miratimin e ndonjë akti përcaktohet me shifra absolute ose me përqindje (3, 5, 10%) nga numri i përgjithshëm i banorëve në njësinë vetëqeverisëse. Referendumi lokal është ushtrim i drejtpërdrejtë i pushtetit nga ana e qytetarëve, përmes të cilit qytetarët bien vendim mbi ndonjë dispozitë lokale ose çështje me rëndësi lokale. Ai është i dëshirueshëm jo vetëm për shkak se është shprehje e demokracisë së drejtpërdrejtë, por edhe për arsye se popullsia vendore më shumë ka njohuri për problemet vendore, sesa popullsia e tërësishme për problemet e rëndësisë nacionale. Kjo është arsyeja pse referendumi lokal organizohet më shpesh dhe ka natyrë të detyrueshme. Disa çështje lokale, megjithatë, mund të dërgohen vetëm për referendum këshillëdhënës, sepse shteti konsideron që ato janë të një rëndësie të atillë sa që për

to duhet të vendos pushteti qendror, ta zëmë, rritja e vëllimit të vetëqeverisjes në bashkësinë apo komunitetin lokal ose ndryshimi i territorit.

10.5. Kompetencat dhe financimi i vetëqeverisjes lokale

Kompetenca e vetëqeverisjes lokale normohet me kushtetutë dhe ligj, si dhe me akte lokale nënligjore. Në rregullimin e kësaj kompetence, mund të fillohet me **numërim taksativ** apo përmes një **klauzole të përgjithshme** që stipulon se vetëqeverisja lokale kryen ato punë që nuk janë lënë në kompetencë të pushtetit qendror. Klauzola e përgjithshme saktësohet përmes **parimit të subsidiaritetit**, i cili niset nga supozimi i kompetencës së organeve të vetëqeverisjes lokale që kryejnë punë publike në dobi të vetëqeverisjes lokale, si niveli pushtetit më i afërm me qytetarin.

Kompetenca e vetëqeverisjes lokale, në kushtetutë zakonisht përcaktohet me formulim të përgjithshëm: nënkupton kryerjen e punëve të komunitetit ose punë me rëndësi lokale, të cilat më tutje specifikohen me ligj. Kushtetuta mund të numërojë disa punë të vetëqeverisjes lokale, duke i ndarë ato sipas rëndësisë, në ndërkohë që ligjit i lihet të përcaktoj të tjerat. Kompetencat e vetëqeverisjes lokale, sipas rregullit ligji i përcakton kryesisht përmes numërimit, në një ose disa ligje, kurse tutje konkretizohen me dispozita nënligjore lokale–statut dhe akte të tjera. Pas kompetencës së përcaktuar përmes **klauzolës së përgjithshme**, formulimet siç janë: punët lokale, çështjet lokale, punët komunale, duhet të pasohen me individualizimin e punëve për të cilat bëhet fjalë.

Në **KEVL**, kompetenca merret si kategori kushtetuese dhe statutare, kurse lihet si mundësi që me ligj të përcaktohen kompetencat e caktuara lokale. Ky dokument themelore evropian, "kushtetuta evropiane për vetëqeverisjen lokale, njeh parimin e klauzolës së përgjithshme dhe parimin prezumimit të kompetencës në kryerjen e punëve publike në favor të vetëqeverisjes lokale. Meqë e drejta e qytetarëve për të qeverisur dhe drejtuar (udhëhequr) mund të realizohet më së miri në nivel lokal, atëherë edhe punët publike duhet të kryhen nga ato organe që janë më së afërmi me qytetarin. Kjo nënkupton që pushtetet tjera, sipas **KEVL** janë pushtete subsidiare (rezervë, ndihmëse).

Mund të dallohen **kompetencat burimore** dhe **kompetencat e bartura** të vetëqeverisjes lokale. Kompetenca burimore janë ato punë që vetëqeverisja lokale i kryen si punë të veta, pa prierje nga pushteti qendror. Këtu hyjnë punë të ndryshme komunale, sipas përmbajtjes së tyre, të cilat, sipas rregullit, do të duhej të ishin të garantuara me kushtetutë, për faktin se vetë vetëqeverisja lokale përfaqëson një kategori të rëndësishme kushtetuese. Si kompetenca të bartura konsiderohet punët që shteti ose niveli i mesëm i pushtetit i bartë në pushtetin lokal, përmes ligjit ose dispozitave nënligjore. Ato punë, në burim i takojnë niveleve të larta të pushtetit, të cilat, me qëllim të ushtrimit të tyre më efektiv dhe ekonomik, barten në kompetencë të pushtetit lokal. Për dallim nga kompetencat burimore, kompetencat e bartura mund të merren nga pushteti më i lartë në do kohë, ashtu siç janë bartur. Dallimi mes këtyre dy llojeve të kompetencave qëndron në **cilësinë e kontrollit** ndaj ushtrimit të tyre. Ekzekutimi i kompetencave burimore i nënshtrohet kontrollit të ligjshmërisë nga ana e organeve të pushtetit qendror, si dhe kontrollit të kushtetutshmërisë. Paligjshmëria e ndonjë akti ose veprimi të përgjithshëm, miratuar ose ndërmarrë me qëllim të ekzekutimit të kompetencës burimore nga pushteti lokal, vërtetohet nga organet e pushtetit qendror: qeveria, gjykata e rregullt, gjykata kushtetuese (në vartësi se për cilin akt ose veprim bëhet fjalë). Një paligjshmëri e tillë korrigjohet (rregullohet) përmes abrogimit ose anulimit të aktit ose veprimit të pushtetit lokal. Këto mundësi i kanë organet e pushtetit qendror dhe të mesëm edhe atëherë kur bëhet fjalë për kontrollin e punëve të bartura, mirëpo këtu kontrolli është më përmbajtësor sepse përfshinë edhe vlerësimin e oportunitetit, pra nëse është arritur qëllimi me kryerjen e tillë të punëve nga pushteti lokal (nëse është dashur të kryhen punët e deleguara në mënyrën si janë kryer). Në këtë rast, deri te abrogimi ose anulimi i aktit ose veprimit, jo domosdo vjen për shkak të paligjshmërisë, por thjeshtë për faktin se pushteti qendror vlerëson se kryerja e punëve nuk është bërë në mënyrë ekonomike dhe efikase. Pra, më fjalë të

tjera, deri te abrogimi ose anulimi aktit ose veprimit vjen për arsye të njëjta për të cilat është besuar kryerja e tyre nga pushtetit lokal.

Në përmbajtjen e kompetencës së vetëqeverisjes lokale hyjnë punët përmes të cilave ndikohet në zhvillimin e ambientit lokal dhe përparimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të tij. Këto duhet të janë punë mjaftueshëm vëllimore dhe të rëndësishme, aq sa përmes tyre vërtetë realizohet vetëqeverisja vendore. Në këtë përmbajtje hyjnë në rend të parë punët komunale. Bëhet fjalë për shërbime që ofron vetëqeverisja lokale me qëllim të plotësimit të nevojave jetësore të qytetarëve, siç janë: furnizimi me ujë dhe kanalizimet, pastrimi, transporti publik, ndriçimi, parkingjet, mirëmbajtja e hapësirave të gjelbra, varrezave dhe kështu me radhë. Punët e vetëqeverisjes lokale janë edhe ato që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor dhe urban, rregullimin e hapësirës, arsimi, shëndetësia dhe veprimtaria sociale, banimi, sporti dhe rekreacioni, mbrojtja e mjedisit jetësor, mbajtja e rendit dhe qetësisë publike, përmes policisë lokale dhe komunale.

Financimi i vetëqeverisjes lokale hyn në aspektet më të rëndësishme të vetëqeverisjes lokale që ka të bëj me realizimin e pavarësisë së saj. Financimi lokal është një sistem elastik, i përshtatur ndaj traditës dhe rrethanave bashkëkohore në të cilat ekziston shteti modern, i varur nga zhvillimi politik dhe ekonomik i shtetit, vëllimi i punëve dhe nevojat e njësive lokale. Në bazë të këtij kriteri matës, **njësitë e vetëqeverisjes lokale mund të ndahen në dy grupe**: ato që mund të plotësojnë nevojat e tyre nga të ardhurat vetjake dhe të tjerat që nuk mund të bëjnë një gjë të tillë. Sa më e madhe vetëqeverisja lokale, e industrializuar dhe e pasur me burime natyrore e veprimtari ekonomike, me tregti dhe turizëm, aq më shumë të ardhura do të realizoj në raport me njësinë e vogël të vetëqeverisjes, që nuk posedon këto atribute. Shih për këtë, ndërhyrja e shtetit është e domosdoshme me qëllim të zvogëlimit të dallimeve mes vetëqeverisjeve të pasura dhe atyre që nuk janë të tilla, krejt kjo me qëllim të zvogëlimit të dallimeve në standardin ekonomik të popullsive të tyre. Këtu shtetet zbatojnë mënyra të ndryshme të financimit të vetëqeverisjeve lokale, përmes mjeteve financiare dhe materiale burimore dhe të bartura, me lloje të ndryshme të lartësisë dhe llojeve të mjeteve dhe burimeve financiare.

Parim fillestar është se **shteti financon pjesërisht** vetëqeverisjen lokale. Nga detyrimi i shtetit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale rrjedh edhe detyrimi i saj për të kontrolluar mënyrën e shpenzimit të mjeteve të bartura. Nga buxheti shtetëror pjesërisht financohen punët komunale dhe punë të tjera, si dhe shpenzimet materiale, rrogat e të punësuarve në organet lokale dhe në administratë. Një pjesë e të ardhurave të buxhetit shtetëror barten në buxhet të njësisë së vetëqeverisjes lokale, kurse në anën tjetër, një pjesë e të ardhurave që realizohet në territorin e njësisë së vetëqeverisjes lokale, i bashkëngjitet buxhetit shtetëror. Në këtë mënyrë, njësitë më të pasura dhe më të mëdha, bartin më shumë mjete në shtet, në shuma absolute, ashtu që ato më pas ndahen mes njësive lokale me qëllim të financimit të nevojave të tyre. Shuma e mjeteve për financim lokal varet nga vëllimi i punëve që kryhen. Njësitë me më shumë pavarësi, do të kenë më shumë kompetenca burimore, që shkakton financim më vëllimor, si nga shteti në mënyrë të drejtpërdrejtë ashtu edhe përmes kthimit më të madh të mjeteve nga tatimet e tatuara për territorin vetëqeverisës.

Përveç mjeteve që barten nga pushteti qendror, njësia e vetëqeverisjes lokale ka edhe burimet vetjake të financimit. Mjetet vetjake të njësisë vetëqeverisëse, varen potencialisht nga madhësia dhe zhvillimi i saj ekonomik. Në anën tjetër, të ardhurat varen nga decentralizimi politik, që përmban përgjigjen në pyetjen sa dhe cilat të ardhura shteti ia len njësisë së vetëqeverisjes lokale për mbledhje.

Burimet vetjake të financimit të vetëqeverisjes lokale kanë statusin e të ardhurave burimore, që nënkupton se i nënshtrohen regjimit juridik që e përcakton vetë njësia e vetëqeverisjes lokale. Pushteti lokal përcakton shkallën e tatimeve lokale, taksave dhe shumave të kompensimeve. Përveç që i rregullon,

vetëqeverisja lokale lirisht disponon me të hyrat vetjake, i harxhon për nevojat e vetëqeverisjes lokale. Një pjesë e të hyrave të pavarura lokale shpenzohet për kompensim të funksionarëve dhe administratës lokale (për punët e kryera jashtë orarit dhe përtej kompetencës standarde që kanë). Në këtë kuptim, do të ishte ideale sikur vetëqeverisja lokale të mund të angazhonte dhe paguante siç duhet kuadrot profesionale e të trajnuara, që janë kompetent për kryerjen dhe përparimin e punëve lokale.

Llojet e burimit të financimit të vetëqeverisjes lokale janë: **tatimet lokale**, **taksat dhe kompensimet**, një pjesë e mjeteve nga **tatimi që i mbledh shteti**, **mjetet e pranuara me destinim të saktë**, **kreditë dhe ngarkesat tjera**, **donacionet**, **ndihmat**, **vetëkontributet**. Tatimet lokale, taksat dhe kompensimet janë të ardhura që i paguajnë qytetarët konform dispozitave të njësisë konkrete të vetëqeverisjes lokale. Dallohen sipas lartësisë dhe varen në politika lokale financiare. Në to hyjnë tatimi lokal mbi pronën, taksat për fitimin e emrit të firmës, kompensimet për rregullim dhe shfrytëzim të tokës ndërtimore, taksat ekologjike dhe të tjera. Një pjesë e mjeteve që mbledh shteti janë, në të vërtetë, tatime shtetërore një pjesë e të cilave ngelet në (ose i kthehet) njësisë së vetëqeverisjes lokale. Një përqindje e tatimit në fitim të personave fizik ose të ndonjë tatimi tjetër, mund të kalon në buxhetin e njësisë vetëqeverisëse, diçka që rregullohet (ose duhet të rregullohet) me ligj. Me mjetet e pranuara me destinim financohen punët e besuara, financim që zgjat deri të kryhen punët e besuara për kryerje. Njësitë e vetëqeverisjes lokale, sipas rregullit, mund të futen në borxh në tregun e kapitalit. Aftësia kredituese nënkupton që njësia vetëqeverisëse mund të merr mjete (kredi) nga kreditorët (banka, fonde, institucione ndërkombëtare) për ushtrimin dhe realizimin e kompetencave të veta, të cilat i shlyen (paguan) nga të ardhurat vetjake. Bashkësia lokale mund të futet në borxh, përkatësisht të financoj, përmes emetimit të letrave me vlerë, me investime dhe ngjashëm me këtë. Në fund, një lloj i posaçëm i burimeve janë donacionet, ndihmat, vetëkontributet.

Me rastin e financimit të vetëqeverisjeve lokale zbatohet parimi i solidaritetit, i cili mbron ata që janë më të dobët ekonomikisht. Për zbatimin e këtij parimi kujdeset shteti dhe vetë njësitë e vetëqeverisjes lokale që ndihmohen financiarisht në mënyrë reciproke. Donator dhe ofrues të ndihmës mund të jenë personat fizikë dhe juridikë. Vetë qytetarët janë donatorë në njësinë vetëqeverisëse kur përmes vetëkontributeve mbledhin mjete për ndonjë destinim të caktuar. Mbi vetëkontributin deklarohen qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe, nëse miratojnë një gjë të tillë, atëherë ai (vetëkontributi) i detyron të gjithë qytetarët e njësisë vetëqeverisëse.

10.6. Kontrolli dhe mbrojtja e vetëqeverisjes lokale

Kontrolli i vetëqeverisjes lokale është **shprehje e marrëdhënies hierarkike** mes organeve të pushtetit në nivele të ndryshme. Shteti ruan për vete të drejtën për kontroll të akteve dhe veprimeve të organeve lokale, që e ushtron përmes mbikëqyrjes, që për pasojë mund të ketë anulimin ose shfuqizimin e të njëjtave. Ky parim rrjedh (buron) nga **parimi i unitetit të rendit juridik**, i cili nënkupton harmoninë e të gjitha akteve, pa marrë parasysh kush i sjell (prodhon). Subjektet e kontrollit të akteve juridike dhe veprimeve të organeve lokale janë: **qeveria**, **gjykatat e kompetencës së përgjithshme** dhe **gjykatat e kompetencës së posaçme**, **gjykata kushtetuese** dhe **organet e autonomisë territoriale**. Gjykatat e rregullta dhe gjykata kushtetuese mund të kontrollojnë vetëm ligjshmërinë e punës së organeve të vetëqeverisjes lokale, në ndërkohë që qeveria (ekzekutivi) mund të kontrolloj edhe **oportunitetin** (nëse ka qenë e arsyeshme ose me vend ndërmarrja) e punëve të besuara për kryerje në vetëqeverisjen lokale. Gjykatat kushtetuese mund të ushtrojnë kontrollin e kushtetutshmërisë së akteve juridike të njësive të vetëqeverisjes lokale, zakonisht ato që janë akte juridike themelore, kurse shumë më rrallë edhe kontrollin e kushtetutshmërisë së veprimeve të organeve të vetëqeverisjes lokale. Kontrollin e fundit mund ta bëj edhe **autonomia territoriale** sa i përket punëve të cilat ajo ia ka besuar vetëqeverisjes lokale për kryerje.

Është bërë e zakonshme dallimi mes kontrollit të akteve dhe punëve në vetëqeverisjen lokale që bazohet në parimin e dekoncentrimit. Vetëqeverisja lokale është një formë e **decentralizimit politik** që nënkupton se, për pasojë, pushteti qendror mund të kontrolloj ligjshmërinë e akteve dhe veprimeve të saj. Organet në

bashkësinë vendore mund të jenë prodhim i **dekoncentrimit të pushtetit**, që nënkupton se, në të vërtetë, bëhet fjalë për bashkësinë vendore të njësisë së administratës jo të pavarur, përkatësisht të varur. Në këtë rast nuk ka pavarësi sa i përket veprimtarisë, sepse, krahas ligjshmërisë, kontrollohet edhe **oportuniteti** (nëse ka qenë e arsyeshme ose me vend ndërmarrja e punëve të besuara për kryerje në vetëqeverisjen lokale).

Të drejtën për kontroll gjithëpërfshirës, të ligjshmërisë dhe oportunitetit, e kanë nivelet më të larta të pushtetit sa i përket atyre akteve juridike dhe veprimeve që organet e njësisë vetëqeverisëse i sjellin dhe ndërmarrin si punë të besuara. Ajo që nuk mund ta bëjnë është se, për shkak të punës së paligjshme dhe mënyrës jo oportune, nuk mund të ndërrojnë kuadrot që kryejnë punët e besuara. Kjo është kështu sepse vetëqeverisja lokale në raport me kuadrot dhe politikën e kuadrit gëzon pavarësi të plotë.

Parakusht për kontrollin e ligjshmërisë së punës së vetëqeverisjes lokale është që organet e saj të kenë mundësi të përgjithshme për kryerjen e punëve të tyre. Marrë parasysh se vetëqeverisja lokale është njësi politike e pushtetit, ka mundësi që, në rrethana të caktuara politike, të vij deri te bllokimi i punës së organeve lokale të pushtetit. Meqë vetëqeverisja lokale ka të bëj me ofrimin e shërbimeve për qytetarin, shteti duhet të parashikoj mekanizëm përmes të cilit mënjanohen pengesat në punën e organeve lokale. Nëse organi përfaqësues lokal nuk thirret (mblidhet) ose nuk mund të merr vendime në afatin e përcaktuar juridikisht ose të zgjedh organet lokale, pushteti qendror ruan të drejtën e shpërndarjes së organit lokal në fjalë dhe, deri në zgjedhjen e një tjetri, të emëroj organet e përkohshme lokale.

Në mënyrë që pushteti qendror mos të abuzoj me pozitën hierarkie më të lartë në raport me vetëqeverisjen lokale, për këtë të fundit parashihet **e drejta e mbrojtjes**. Për vetëqeverisjen lokale, shteti ofron mbrojtje nga vetë ai. Me qëllim të ruajtjes së pavarësisë dhe kryerjes së lirshme të punëve, vetëqeverisjes lokale i ngelin në disponim **mjete të caktuara juridike**. Organet e vetëqeverisjes lokale mund të ankohen te pala e tretë për aktet e organeve të nivelit më të lartë të pushtetit, me të cilat kufizohet ose pamundësohet veprimtaria e saj. Sipas natyrës së gjërave, ai organ duhet të jetë **apolitik** dhe **neutral** në mosmarrëveshjen mes shtetit dhe regjionit me njësinë e vetëqeverisjes lokale. Në këtë kuptim, mjetet për mbrojtjen e vetëqeverisjes lokale do të parashtrohen pranë gjykatave, si **organe apolitike** dhe **neutrale** të shtetit për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë në vend. Bazuar në **natyrën e kontestit**, në vijën e parë të mbrojtjes do të jetë e thirrur gjykata e rregullt, nëse, ta zëmë, njësia e vetëqeverisjes lokale ka marrë më pak mjete financiare sesa ka qenë e përcaktuar juridikisht. Gjykata kushtetuese, sërish bazuar në natyrën e kontestit, do të shërbej si mbrojtës i vetëqeverisjes lokale nëse, ta zëmë, duhet të vlerësohet **kushtetutshmëria dhe ligjshmëria e akteve** me të cilat pamundësohet ose kufizohet realizimi i vetëqeverisjes lokale. Në rastet kur pushteti qendror provon uzurpimin e ndonjë kompetence të pushtetit lokal, sërish gjyqësia kushtetuese paraqitet si profesioni më adekuat për vendosje në kontestin rreth konfliktin për kompetencë dhe mbrojtje të vetëqeverisjes lokale.

11. Vetëqeverisja lokale në Kosovë dhe vendet përreth

11.1. Kosova

11.1.1. Historiku deri në nxjerrjen e Kushtetutës së RSFJ 1974 dhe Kushtetutës së KSAK (1974)

Shtjellimi i vetëqeverisjes lokale në Kosovë duhet të ndahet në fazën para dhe atë pas shpalljes së pavarësisë së vendit më 17 shkurt 2008. Faza e parë, para fitimit të pavarësisë, kap periudhën e ish-Jugosllavisë (1918-1992), kurse faza e dytë nga çlirimi i Kosovës (10 qershor 1999) deri më sot.

Historiku i qeverisjes lokale në Kosovë, domosdo që duhet të filloj me konceptin dhe praktikën e vetëqeverisjes lokale në territorin e ish-Jugosllavisë, para dhe pas **Luftës së Dytë Botërore**. Kjo formë e qeverisjes nuk ka qenë e varur nga statusi i kombeve dhe popujve të ish-Jugosllavisë, meqë njësitë e

qeverisjes lokale kanë ndjekur konceptin gjithëjugosllav të ndarjes administrative dhe qeverisjes vendore. I vetmi përjashtim në këtë drejtim ka qenë kur koha kur themelua regjioni asimetrik, gjysmëfederal, në favor të kroatëve dhe që njihet si **Banovina Kroate** (1939-1941). Ajo që nuk thuhet në këtë seksion, por në seksionet në vijim, ndërsa ka të bëj me periudhën e ish-Jugosllavisë, **mutatis mutandis** vlen edhe për Kosovën, për aq sa kjo ka të bëj me periudhën e njëjtë (1918-1989).

Ish-**Jugosllavia** është themeluar më 1 dhjetor 1918. Si subjekt i së drejtës ndërkombëtare, me rregullime të ndryshme kushtetuese, ka ekzistuar deri në prill të vitit 1992, kur është themeluar **Jugosllavia e Milosheviqit**, e përbërë nga Serbia dhe Mali i Zi dhe që njihet me shkurtesën e përmendur më herët, si **RFJ**. Edhe ky entitet ka ekzistuar me forma të ndryshme kushtetuese: forma e parë si federatë deri më 2003, kurse pas këtij viti si bashkësi shtetërore ose union i dy shteteve: Serbi dhe Mali i Zi, të cilën më sipër e kemi emërtuar si **BSHSMZi.** Mes dy luftërave botërore, **ish-Jugosllavia** ka pasur **rregullim monarkik**. Qeverisja lokale dhe ndarja administrative e shtetit jugosllav ka qenë e ndryshme në dy periudhat si më sipër.

Kushtetuta e parë e atij shteti është miratuar në vitin 1921 dhe njihet me emrin **Kushtetuta e Vidovdanit** (KVid), sipas emrit të një feste kishtare serbe. Deri në KVid ka ekzistuar qeverisja lokale që ka ekzistuar në territoret që iu bashkëngjiten këtij shteti të ri. Kjo nënkupton qeverisjen lokale sipas standardeve të **Perandorisë Austrohungareze** (a i përket pjesës veriore të ish-Jugosllavisë) dhe mbretërive **Serbe** dhe **Malazeze** (vetëm sa i përket territoreve të këtyre dy mbretërive që u shkrinë në shtetin e ri jugosllav). Vetëqeverisja lokale në periudhën para vitit 1918 nuk ka ndonjë relevancë që meriton vëmendjen tonë. **KVid** ka vënë themelet e reja për rregullimin e ri shtetëror, përfshirë edhe qeverisjen lokale. Sipas **KVid**, vetëqeverisja lokale sanksionohet në tri nivele:

- komuna;
- rrethi (**srezi**); dhe
- regjioni (**oblast**).

Administrata në nivel **srezi** kurrë nuk është ndërtuar. **Srezet** kanë vepruar si organe të shtetit, si **sreze administrative** ("upravni srezovi"). Regjionet kanë vepruar njëkohësisht si organe administrative dhe organe të vetëqeverisjes lokale. Kjo ka zgjatur deri më 1929, kur mbreti jugosllav **Aleksandri i Parë** (Alexander I of Yougoslavia: 1888-1934) futi diktaturën e njohur si "diktatura e 6 janarit". Në periudhën 1921-1931 ka ardhur deri te zvogëlimi i numrit të komunave dhe rritjes së numrit të srezeve, tendencë kjo e centralizimit shtetëror, prezente gjatë tërë kohës si rrjedhojë e nacionalizmit dominant serb dhe synimit të tyre për hegjemoni absolute në çdo pore të atij shtetit. Kjo shpjegon edhe faktin që vetëqeverisja në nivel **oblast**-i, si nivel regjional i vetëqeverisjes, nuk kam mund të zhvillohet, shkaku i nënshtrimit ndaj organeve shtetërore qendrore. Në një shtet me rregullim shtetëror centralist nuk ka mund të zhvillohet vetëqeverisja lokale. Kjo sepse marrëdhëniet politike në një shtet të centralizuar nuk janë të përshtatshme për zhvillim të vetëqeverisjes lokale. Organet lokale të pushtetit kanë qenë në shërbim të administrimit të centralizuar të vendit. Marrëdhënie edhe më të papërshtatshme për vetëqeverisje lokale krijohen me futjen e **diktaturës së 6 janarit**: tani e tutje krejt pushtetin ligjvënës dhe ekzekutiv e merr mbreti serb i Jugosllavisë. Monarkia që formalisht cilësohet si monarki kushtetuese e kufizuar, u zëvendësua me monarki absolute. Edhe formalisht, shteti ndryshon emrin, nga **Mbretëria Serbo-Kroato-Sllovene** (Mbretëria SKS) në **Mbretëria Jugosllave** (MJug). Me futjen e kësaj diktature, hiqen regjionet (oblast) dhe futen **banovinat**, nëntë sosh (sipas lumenjve kryesor të ish-Jugosllavisë, por edhe bazuar në disa kritere të tjera periferike), prishen kuvendet komunale dhe komunat si njësi themelore të qeverisjes lokale. Si njësi themelore ngelet vetëm vetëqeverisja komunale: me nenin 96 të **Kushtetutës së Mbretërisë Jugosllave** të vitit 1931 (KJ 1931), të cilët mbreti **Aleksandri Parë** ia dhuroi popullit jugosllav, "[...] Komunat përcaktohet si trupa vetëqeverisës. Aty me ligje të veçanta mund t'u vihet

në ngarkesë edhe aktet e pushtetit administrativ, të cilat ato i kryejnë nën mbikëqyrjen organeve të caktuara administrative". Në bazë të KJ 1931, janë miratuar **Ligji për komunat** (1934) dhe **Ligji për komunat e qytetit** (1934).[86]

Pas mbarimit të **Luftës së Dytë Botërore** ndërtohet një model tipik **stalinisto-komunist** i qeverisjes lokale, modeluar në tërësi sipas teorisë dhe praktikës sovjetike, nëse mund të thuhet se ka ekzistuar fare ndonjë nivel i qeverisjes lokale në kuptimin modern të fjalës. Bërthamat e tij hasen në të ashtuquajturat **këshillat nacional-çlirimtarë**, të cilët morën fuqi kushtetuese e ligjore pas vitit 1946, bazuar në **KJ 1946** dhe ligjet që u nxorën në vijim të operacionalizimit të rolit dhe pozitës së tyre dominante kushtetuese, bazuar në ideologjisë dominante të **Partisë Komuniste të Jugosllavisë** (PKJ). Sipas **KJ 1946**, **këshillat popullorë**, që u formuan gjatë **Luftës së Dytë Botërore** nga partizanët e **Titos**, nuk ishin organe të vetëqeverisjes lokale, sepse ato definoheshin si organe të pushtetit shtetëror. Cilësi themelore e kësaj periudhe është centralizimi i madh shtetëror, bazuar në monopolin politik të **PKJ-së** në të gjitha nivelet e pushtetit. Diçka e ngjashme sot ekziston në **Kinën komuniste**.

Në periudhën 1946-1989 (deri në rrënimin e autonomisë së Kosovës më 23 mars 1989), janë bërë disa ndryshime në renditjen dhe rregullimin e vetëqeverisjes lokale, që kanë qenë **uniforme** në nivel jugosllav. Bëhet fjalë për ndryshime që kanë pasur të bëjnë me bazën ligjore dhe kushtetuese të vetëqeverisjes lokale, kompetencën dhe organizimin territorial të tyre. Në këtë kuptim mund të dallohen dy periudha të zhvillimit, që përfundojnë në vitin 1989. Periudha e parë karakterizohet me udhëheqjen administrative shtetërore centraliste në nivel të krejt Jugosllavisë komuniste. Kjo periudhë përfshinë jo vetëm **këshillat popullorë**, por të gjitha nivelet e drejtimit, si të punëve administrativo-shtetërore ashtu edhe të atyre ekonomiko-shoqërore dhe kulturore. Kjo kohë zgjat deri në vitin 1953 (miratimi i **LK 1953**). Këtë vit nis periudha e dytë, faza e drejtimit vetëqeverisës të shoqërisë që zgjatë deri në vitin 1989. Në fakt, një vit para nxjerrjes së LK 1953, është miratuar, që ka paralajmëruar sistemin komunal që po krijohej. Më 1953 miratohen ligjet që implementojnë përcaktimin kushtetues të vitit të njëjtë për futjen e **komunës** si formë e organizimit vetëqeverisës dhe vendosjes së qytetarëve, përkatësisht dy ligjet federale që vënë në jetë reformën kushtetuese të vitit 1953: **Ligji i përgjithshëm mbi rregullimin e komunave dhe srezeve** (1955) dhe **Ligji për kompetencat e këshillave popullorë nëpër komuna dhe sreze** (1955). Nga kjo kohë komunat dhe **srezet** përfaqësojnë njësitë e vetme që definohen me ligj, kurse të tjerat që kishin ekzistuar suprimohen, në ndërkohë që komuna ngelet njësia e vetme e vetëqeverisjes lokale. Në këtë fazë, **këshillat popullorë** akoma përfaqësojnë **organet e pushtetit shtetëror** në këto dy njësi (në srez dhe në komunë). Në vitin 1967, srezet eliminohen fare dhe ngelet vetëm **komuna**. Në vend të srezeve formohen **bashkësitë lokale**, si një lloj organi i komunës (i barsavlefshëm me këshillat lokalë në Kosovën e sotme), e cila ngelet njësi e vetme e vetëqeverisjes lokale.[87]

Pas ndryshimeve kushtetuese në vitin 1963, përkatësisht pas miratimit të **KJ 1963**, konceptualisht nuk ndryshon asgjë: sërish republikat përcaktojnë me ligje ndarjet e tyre administrativo-territoriale, bazuar në definimet kushtetuese dhe përcaktimet e ligjeve federale si më sipër. Sistemi i ri i qeverisjes lokale tani emërtohet si **sistemi komunal i vetëqeverisjes**. Ndryshimet esenciale në organizimin e pushtetit në këtë fazë janë bërë në parimin e decentralizimit, përkatësisht me kalimin e një sërë funksioneve dhe autorizimeve te organet e ulëta, veçanërisht në organet e njësive administrativo – territoriale. Kjo periudhë, në kuptim të vetëqeverisjes lokale, karakterizohet me futjen përfundimtare të **sistemit të komunave**. Pikë nisëse e konceptit të **vetëqeverisjes komunale** ka

[86] Cf. më shumë për këtë në Zeljko Fajfric, "Lokalna samouprava u ustavnom sistemu Jugosllavije i Srbije". *Glasnik Advokatske Komore Vojvodine* God. LXXI Br. 11 (Septembar 1999), fq. 391-397 në fq. 393-394 (vetëm në alfabetin cirilik, në gjuhën serbe).

[87] Duško Lozina i Josipa Jagnjić, "Razvoj lokalne samouprave u Republici Hrvatskoj" *Zbornik radova Pravnog fakulteta u Splitu*, God. 58, No. 2 (2021), fq. 555-585, në fq. 567.

qenë kjo: qytetari merr pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në vendosje për punët publike në bashkësinë e lokale. Kjo vendosje zhvillohej në njësitë prodhuese (ndërmarrje), bashkësi lokale (tubimi i qytetarëve), me referendum dhe përmes pjesëmarrjes në zgjedhje të lirë të organeve përfaqësuese (këshillit/kuvendit komunal). KJ 1963, në nenin 96 e definon **komunën** si një organizatë bazë politiko-territoriale vetëqeverisëse e popullit punues dhe bashkësi themelore shoqëroro-ekonomike e banorëve që banojnë në te. Komuna kryen të gjitha të drejtat dhe detyrat e drejtimit me shoqërinë, përveç atyre punëve që me kushtetutë e ligj janë lënë në kompetencë të organeve më të larta të shtetit.[88] Në këtë mënyrë, në favor të komunës ka ekzistuar **prezumimi i kompetencës**. Me këtë është institucionalizuar **parimi i decentralizimit** në drejtimin e punëve shoqërore. Më këtë futet edhe njëtrajtshmëria në pozitën dhe strukturën e komunës në të gjitha vendbanimet (urbane dhe rurale), e njohur si **organizata monotip**.

Organizimi i vetëqeverisjes në komunë bëhet me të drejtën autonome të komunës për nxjerrjen e **statutit** të saj, i cili konsiderohet si akti më i lartë i vetëqeverisjes komunale. Me te rregullohen organet (struktura) e vetëqeverisjes komunale, kompetencat e tyre, të drejtat e qytetarëve për vendosje, të drejtat materialo-financiare të komunës, administrimi me pronën, mbledhja e të ardhurave të punës vetjake (e drejta për buxhet të mëvetësishëm). Komuna si njësi themelore në përshkrimin si më sipër, ka pasur kompetenca të përcaktuara me kushtetutën federale (kompetenca burimore), kurse territori i saj përcaktohej me ligjin republikan (pas vitit 1974 edhe me ligjet e krahinave autonome). Në kompetencat burimore të komunave kanë hyrë sa vijon:

- sigurimi i kushteve materiale dhe të tjera të njerëzve dhe për zhvillim të forcave prodhuese;
- drejtimi dhe harmonizimi i zhvillimit ekonomik dhe të shërbimeve shoqërore;
- përcaktimi dhe shpërndarja e të hyrave (buxheti i mëvetësishëm i komunës);
- krijimi i kushteve për plotësimin e nevojave të përbashkëta të qytetarëve, atyre sociale, kulturore dhe nevojave të tjera;
- harmonizimi i interesave individuale dhe të përbashkëta me interesat e përgjithshme;
- organizimi i organeve të pushtetit, i vetëqeverisjes dhe shërbimeve shoqërore;
- sigurimi i kushteve për realizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut;
- përcaktimi i kushteve të përgjithshme për ushtrimin e veprimtarive të organizatave dhe institucioneve komunale;
- mbrojtja e sigurisë së njerëzve dhe pasurisë; dhe, së fundi,
- sigurimi i rendit dhe qetësisë publike. [89]

Sa i përket Kosovës së kësaj periudhe, gjendja ka qenë më ndryshe se në krejt njësitë tjera të Jugosllavisë komuniste. Shumëçka për këtë u diskutua më herët te pjesa mbi autonominë e Kosovës. Këtu do t'i rikapitulojmë shpejt disa segmente, për të kaluar në çështjen e vetëqeverisjes lokale në Kosovë. Në vitin 1953 u miratua **Statuti i KAKM-së**. Institucionet vendimmarrëse më të larta të Kosovës ishin: Këshilli Popullor, Këshilli Ekzekutiv Krahinor dhe organet krahinore të administratës. Me nxjerrjen e **LK 1953** dhe **LKS 1953**, siç u pa më sipër, pozita kushtetuese e Kosovës u degradua edhe më shumë. Gjatë kësaj periudhe organizimi i qeverisjes lokale u bazua në aplikimin e sistemit jugosllav të centralizmit demokratik, ku organet lokale të pushtetit vendosës janë të varura në pikëpamje hierarkike nga organet qendrore. U mor vesh, edhe në Kosovë vlente **LK 1953**, ashtu që njësitë bazë të vetëqeverisjes lokale ishin **komunat** që kishin funksione të shumta në ushtrimin e pushtetit (siç u përshkruan më sipër). Nga reforma komunale e vitit 1952, territori i Kosovës u nda në 195 komuna. Këto organe lokale të pushtetit u vendosën nën hierarki të dyfishtë ndaj organeve qendrore krahinore dhe ndaj organeve republikane të Serbisë. Vendosja e tillë ishte

[88] Zeljko Fajfric, "Lokalna samouprava u ustavnom sistemu Jugosllavije i Srbije ", fq. 394

[89] Cf. Vojislav Simović, *Komunalni sistem i komunalna politika* (Naučna knjiga: Beograd, 1966), fq. 129-131; Cf. më shumë edhe në Milivoje Kovacevic, *Komunalni sistem i komunalna politika* (Zavod za idavanja udjbeniak SR Srbije: Beograd, 1968) (dy librat janë në alfabetin cirilik, në gjuhën serbe).

një centralizëm total i pushtetit qendror. Në vitin 1963 u miratuan **Kushtetuta Jugosllavisë** komuniste dhe kushtetutat e republikave socialiste. Sikundër u pa më herët, në këtë vit Kosova nxori statutin e vet, me të cilin u përcaktua edhe numri i komunave kosovare: tani vendi ndahej në 22 njësi komunale dhe 5 rrethe.

11.1.2. Periudha para fitimit të pavarësisë: nga nxjerra e Kushtetutës së RSFJ 1974 dhe Kushtetutës së KSAK-së

Këtu përfshihet qeverisja lokale në Kosovë sipas këtyre dokumenteve: **Kushtetutës RSFJ 1974**, **Kushtetutës KSAK 1974** dhe **Kushtetutës së Kaçanikut** (1990), e cila asnjëherë nuk gjeti zbatim efektiv shkaku i rrethanave të okupimit brutal serb (1989-1999).

Kushtetuta e RSFJ 1974 i ka dhënë një pozitë më të favorizuar pozitës kushtetuese të Kosovës në kuadër të **Jugosllavisë komuniste**. Kjo kushtetutë promovoi, për herë të pare, konceptin e një federate të decentralizuar, duke i dhënë një pozitë më të rëndësishme nivelit të **qeverisjes lokale**, i cili, krahas rolit parësor të komunave, ka parashikuar edhe organizimin e bashkësive vetëqeverisëse të interesit dhe organizatat e punës së bashkuar, si shtylla të vetëqeverisjes socialiste. Sipas nenit 116 të **Kushtetutës së RSFJ 1974**, **komuna** ishte një bashkësi themelore vetëqeverisëse dhe shoqërore-politike, njëjtë si në periudhën e mëhershme, e bazuar në pushtetin dhe vetëqeverisjen e klasës punëtore dhe të të gjithë të punësuarve. Të drejtat, detyrat si dhe organet e komunës janë të përcaktuara në **kushtetutën republikane dhe krahinore**, krahas definimit të saj me **Kushtetuta e RSFJ 1974** si njësi themelore e vetëqeverisjes lokale, si dhe me **statutin e komunës**.

Organet kryesore të komunës ishin: **kuvendi i komunës**, i cili e zgjidhte kryetarin e komunës; **këshilli ekzekutiv i komunës**; **organet komunale të administratës**; **avokati publik komunal** (neni 126 i **Kushtetutës së KSAK-së** të vitit 1974). **Statuti** si akti më i lartë normativ i komunës, përcaktonte organizimin dhe veprimtarinë e komunës dhe të organeve të saj. Gjatë kësaj periudhe **mëvetësia e pushtetit lokal** ishte në një shkallë më të lartë në raport me organet krahinore dhe nuk kishin varësi nga organet republikane. Krahas funksioneve ekonomike, administrative dhe politike që tani ishin të garantuara me kushtetutë, ato gëzonin edhe të drejtën e bashkëpunimit ndërkombëtar në sferën e zhvillimit ekonomik. Pas vitit 1981 statusi politik-kushtetues i Kosovës dhe autonomia që ishte fituar me **Kushtetutën RSFJ 1974** zvogëlohet në praktikë në mënyrë graduale, si rrjedhojë e një ndërhyrje të drejtpërdrejt nga ana e organeve të Serbisë, në organet lokale të qeverisjes, duke marrë pas marsit të vitit 1989 nën kontroll e drejtpërdrejt të drejtën dhe veprimtarinë e komunave në ushtrimin e kompetencave të tyre. Për rrjedhojë, u anuluan të gjitha vendimet e organeve lokale, u realizuan inspektime arbitrare nga ana e organeve të **Republikës së Serbisë** me qëllim zëvendësimin e administratës në organet lokale. Rrënimi edhe formal i pozitës kushtetuese të Kosovës bëri që të suprimoheshin të gjitha organet kushtetuese të vendit nga organet e pushtetit okupues serb. Për këtë suprimim, Republika e Serbisë u kujdes që formalisht të nxjerr një legjislacion, mjaft diskriminues, në rrethana të jashtëzakonshme dhe të veçanta. Përmes ligjeve diskriminuese për veprimin e organeve republikane serbe në rrethana të jashtëzakonshme, u vendos suprimimi i kuvendeve komunale në komunat e Kosovës, të themeluara sipas **Kushtetutës RSFJ 1974** dhe **Kushtetutës KSAK 1974**, duke i zëvendësuar ato me administratën e dhunshme serbe, e cila largoi të gjithë punëtorët shqiptarë nga administrata komunale. Pas shumë zhvillimeve politike që dëshmuan hapur shpërbërjen e pashmangshme të **Jugosllavisë komuniste**, deputetët e atëhershëm të Kuvendit të KSAK-së, që ishte suprimuar nga organet e Republikës së Serbisë, miratuan **Deklaratën Kushtetuese** më datën 2 korrik 1990 (“Deklarata Kushtetuese “), që shprehte vullnetin politik të qytetarëve të Kosovës për të qenë e barabartë me njësitë tjera federale të **Jugosllavisë komuniste** dhe popujt e tyre.

Në vijim të implementimit të **Deklaratës Kushtetuese**, të njëjtit deputetë të Kuvendit të Kosovës, më 7 shtator 1990, miratuan aktin më të lartë juridik, që në historinë më të re kushtetuese dhe

politike të Kosovës njihet si Kushtetuta e Kaçanikut, kurse më 26-30 shtator të vitit 1991 u mbajt një referendum popullor për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur. Ky referendum nuk rezultoi me njohjen ndërkombëtare të shtetësisë së Kosovës që u shpall. Në vitet 1989-1999, Kosova organizoi një sistem paralel, për të rezistuar okupimin serb, duke themeluar organe paralele të shëndetësisë, kulturës, arsimit, shkencës dhe, në fund, edhe të mbrojtjes përmes **UÇK-së.** Kjo periudhë nuk mund të shpjegohet me terma juridiko-kushtetues, ashtu që del jashtë suazave të trajtimeve tona. Këtu fokusohemi shkurt në dokumentin e sipërcekur kushtetues, **Kushtetutën e Kaçanikut**, e cila e **përcaktoi komunën si një njësi territoriale**, në të cilën qytetarët realizojnë vetëadministrimin e saj, në harmoni me **statutin e komunës**.

Republika me ligj mund t'i besojë komunës kryerjen e disa punëve (neni 87 i **Kushtetutës së Kaçanikut).** Kushtetuta dhe ligji (i cili kurrë nuk është miratuar për shkak të rrethanave të okupimit) përcaktonin që **komuna**, nëpërmjet organeve të veta, realizon këto funksione:

- miraton programin e zhvillimit ekonomik lokal, planin urbanistik, buxhetin dhe llogarinë përfundimtare;
- siguron zhvillimin e veprimtarive komunale dhe dispozitat e veta, cakton kriteret e përgjithshme për ushtrimin dhe kryerjen e tyre
- përkujdeset për ndërtimin, mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale si dhe të objekteve të tjera publike, të cilat janë me interes komunal;
- rregullon shfrytëzimin e tokës ndërtimore dhe të hapësirës afariste;
- përkujdeset për përmbushjen e nevojave të qytetarëve në fushën e arsimit, kulturës, shëndetësisë, mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve, të kulturës fizike, zejtarisë, turizmit, të mbrojtjes e përparimit të mjedisit jetësor dhe në sfera të tjera të përcaktuara me statutin e komunës dhe me akte të tjera komunale, me interes të drejtpërdrejtë për qytetarët të cilët jetojnë në territorin e komunës;
- siguron zbatimin e dispozitave komunale si dhe të ligjeve dhe dispozitave të tjera republikane, realizimi i të cilave i është besuar komunës; dhe
- formon organe, organizata dhe shërbime të komunës (neni 88 i **Kushtetutës së Kaçanikut).**

11.1.3. Periudha pas fitimit të pavarësisë – nga Kushtetuta e Kaçanikut deri te shpallja e pavarësisë më 17 shkurt 2008 dhe tutje

Pas rënies së komunizmit, vetëqeverisja lokale në krejt ish-republikat jugosllave merr një dimension dhe përmbajtje tjetër, të cilën e diskutojmë veç e veç për secilin vend fqinjë. Ajo që nuk diskutojmë në kontekstin e Kosovës është periudha e okupimit të tërësishëm serb (1989-1999), kur krejt Kosova ka qenë një njësi administrativo-politike, **e llojit kolonial të guvernantës**, që është drejtuar nga **Beogradi** përmes një guvernatori.

Kosova pas çlirimit më 10 qershor 1999, nga forcat e **NATO**-s dhe të **UÇK-së**, është futur nën administrimin ndërkombëtar të **Kombeve të Bashkuara**, i njohur si misioni **UNMIK**. Ky mision ka operuar sipas rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së ("Rez.1244"). Gjatë periudhës së administrimit ndërkombëtar Kosova kishte gjithsej 30 komuna, të cilat u caktuan me **Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/43 të** datës 27 korrik 2000 ("Rregullorja nr. 2000/43").[90] Secila prej këtyre tridhjete (30) komunave kishte vendbanimet e saj, si dhe zonën e vet kadastrale.[91] Bazuar në një rregullore tjetër, në **Rregullore nr. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës** ("Rregullorja nr. 2000/45"), të datës 11 gusht 2000, nenet e saj 4 dhe 5, akti me i larte i qeverisjes se komunës, në kohën e administrimit ndërkombëtar, ka qenë statuti i komunës. Komunat kishin të drejtë të nxirrnin edhe rregullore lokale, me

[90] *Rregullore UNMIK-ut nr. 2000/43, datë 27 korrik 2000, mbi numrin, emrat dhe kufijtë e komunave. Aneksi A.*
[91] Ibid., *Ankesi B*.

qëllim të rregullimit të veprimtarisë se tyre, përfshirë bashkëpunimin mes fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.[92] Në përgjithësi, aktet si më sipër të UNMIK-ut, promovonin parimin e transparencës dhe të demokracisë lokale. Në mbledhjet e kuvendeve komunale dhe organeve të tjera lejoheshin të merrnin pjesë qytetaret, por edhe çdo përfaqësues i mediave. Pjesëmarrja e tyre kufizohej në rast se zbulimi i informatave mund të shkaktonte çrregullim në publik apo nëse do të zbuloheshin informacione konfidenciale, informacione të ndjeshme personale apo edhe informata që kanë të bëjnë me proceset gjyqësore (neni 7 i **Rregullores nr. 2000/45**). Kushtet e pjesëmarrjes se publikut në mbledhjet e organeve komunale përcaktoheshin në detaje vetëm me statutin e komunës, i cili, duhet thënë, duhet të ishte në pajtim me rregulloret e UNMIK-ut dhe rrjedhte nga to. Sa i përket demokracisë lokale, si mekanizma përmes të cilave qytetarët ushtronin pushtetin e tyre të drejtpërdrejtë, ishin **tubimet publike** dhe **peticionet**. Së paku dy (2) herë në vit, secila komunë duhej të organizonte tubime publike, ku mund të merrnin pjesë qytetarët. Në këto tubime përfaqësuesit e komunave informonin qytetarët për aktivitetet e tyre brenda fushëveprimit te komunave. Po ashtu, secili person fizik apo juridik, si organizatë, kishte të drejtë për paraqitjen e peticionit për çështjet që kanë pasur të bëjnë me fushëveprimin e komunës. Peticioni shqyrtohej në bazë të procedurave të përcaktuara me statut dhe rregullat e tjera të komunës (neni 8 i **Rregullores nr. 2000/45**).

Rregullorja nr. 2000/45, përveç çështjeve si më sipër, përcaktonte edhe fushëveprimin e pushtetit të komunave. Në këtë kuptim, secila komunë, brenda territorit të saj, kishte kompetenca për çështjet si në vijim:

- ofrimin e kushteve themelore lokale për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;
- planifikim urban dhe rural dhe shfrytëzim të tokës;
- lëshimin e lejeve për ndërtim dhe zhvillim;
- mbrojtjen lokale të ambientit;
- zbatim të rregullave të ndërtimit dhe kontrollim të standardeve të ndërtimit;
- ofrim të shërbimeve publike lokale dhe të infrastrukturës, përfshirë furnizimin me ujë, ujësjellësin dhe kanalizimin, përpunimin e ujërave të zeza, mirëmbajtjen e rrugëve lokale, transportin lokal dhe planet për ngrohtoret lokale;
- shërbime publike, përfshirë shërbimin e zjarrfikësve dhe të emergjencës;
- administrim me pronën e komunës;
- shkollim parashkollor, fillor dhe të mesëm;
- kujdes primar shëndetësor;
- shërbime sociale dhe strehim;
- mbrojtje të konsumatorëve dhe shëndetin publik;
- lëshim të lejeve për shërbime dhe pajisje, përfshirë argëtimin, ushqimin, tregjet, shitjet në rrugë, transportin lokal publik dhe shërbimin e taksistëve, gjuetinë dhe peshkimin, restorantet dhe hotelet;
- panairet dhe tregjet;
- emërimi dhe riemërimi i rrugicave, rrugëve dhe vendeve të tjera publike;
- sigurimi dhe mirëmbajtja e parqeve publike, hapësirave të hapura dhe varrezave;
- aktivitete të tjera të ngjashme dhe të rëndësishme për administrimin adekuat të territorit komunal, që nuk janë të përcaktuara gjetiu me ligj (neni 3.1 i **Rregullores nr. 2000/45**).

Përveç në çështjet si më sipër, brenda territorit të tyre dhe duke respektuar ligjet e nivelit qendror, komunat mund të ndërmerrnin veprime edhe në fushat tjera, siç janë: turizmi, aktivitetet kulturore, sportet dhe aktivitetet e lira, aktivitetet e rinisë, avancimi i ekonomisë, avancimi i vlerave qytetare (neni 3.2 i **Rregullores nr. 2000/45**). Komunat kishin përgjegjësi edhe për zbatimin e rregulloreve dhe ligjeve të pushtetit qendror, për çështjet si vijon: të dhënat kadasdrale, regjistrin e popullsisë, regjistrin e votuesve

[92] *Rregullore e UNMIK-ut nr. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, datë 11 gusht 2000.*

etj. Pushteti qendror mund të lejonte që komunat të ushtrojnë kompetencave që i takonin pushtetit qendror, në formë të **delegimit**, me kusht që për këtë çështje të siguronte edhe buxhetin (nenet 3.3 dhe 3.4 të **Rregullores nr. 2000/45**). Përveç marrëdhënieve me pushtetin qendror, për ushtrimin e kompetencave të tyre, komunat kishin të drejtë të lidhnin marrëveshje ndërmjet tyre.

Në bazë të **Rregullores nr. 2000/45,** organet kryesore të komunës ishin: **kuvendi komunal**; **kryetari i komunës**; **kryeshefi ekzekutiv**; **bordi i drejtoreve**; **administratori komunal**. Të gjitha këto organe ushtronin pushtetin dhe fushëveprimin e tyre, nën mbikëqyrjen e pushtetit qendror, respektivisht të administratës së UNMIK-ut. Pas hyrjes ne fuqi të **Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme**, që kishte formën e **Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, datë 15 maj 2001** ("Korniza Kushtetuese"),[93] është hequr kategoria e administratorëve ndërkombëtarë në kuadër të komunave. Ky ndryshim ishte pjesë e procesit të nisur për bartje të kompetencave, nga administrata ndërkombëtare e UNMIK-ut tek organet vendore, respektivisht tek **Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë** (IPVQ), të cilat u themeluan me **Kornizën Kushtetuese**.

Kuvendi komunal përbënte organin më të lartë të qeverisjes, i cili ushtronte pushtetin dhe detyrat e komunës dhe zgjidhej përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta, në komunën përkatëse. Secila nga tridhjetë (30) komunat e Kosovës e kishte të përcaktuar numrin e anëtarëve të kuvendit komunal. Numri më i ulët i anëtareve të një kuvendi komunal, ishte shtatëmbëdhjetë (17), kurse numri më i lartë ishte pesëdhjetë e një (51), të cilin numër e kishte **Kuvendi Komunal i Prishtinës** (neni 10.2 i **Rregullores nr. 2000/45**). Mandati i parë i anëtarëve të kuvendit komunal ishte dy (2) vjet, më pas secili mandat në vijim ishte mandat katër (4) vjeçar. Ndër **kompetencat kryesore** të **kuvendit komunal** ishte ajo për miratimin, plotësimin dhe ndryshimin e statutit të komunës, të cilin mund ta bënte me dy të tretat (2/3) e anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë, në mbledhjen ku vendoset një gjë e tillë (neni 11.2 i **Rregullores nr. 2000/45**). Disa nga kompetencat e kuvendit të komunës nuk mund të barteshin tek një organ tjetër. Të tilla ishin: miratimi i buxhetit, miratimi i çështjeve të tjera financiare, kompensimet për anëtarë të zgjedhur, miratimi, ndryshimi dhe anulimi i zgjedhjeve lokale, krijimi i komiteteve të komunës, zgjedhja e kryetarit dhe nënkryetareve të komunës, emri i kryeshefit ekzekutiv, emërimi i bordit të drejtorëve, krijimi dhe përdorimi i simboleve, dekorimeve dhe titujve te nderit, emërimi dhe riemërimi i rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike (neni 11.3 i **Rregullores nr. 2000/45**). Kuvendi **mund të delegonte** pushtetin e tij vendimmarrës tek një komitet komunal, kryetari apo kryeshefi ekzekutiv, ndonëse delegimi mund të revokohej në çdo kohë nga ana e kuvendit. Kuvendi duhej të mbante mbledhjen e parë të tij, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga data e verifikimit dhe certifikimit te zgjedhjeve në komunën përkatës. Mbledhjen e parë të tij e kryesonte përfaqësuesi më i vjetër, deri në betimin e kryetarit të zgjedhur (neni 12 i **Rregullores nr. 2000/45**). Anëtarët e kuvendit merrnin mandatin e tyre, pas dhënies së betimit dhe nënshkrimin e deklaratës nën betim. Kuvendi e kishte obligim që të mbante së paku dhjete (10) mbledhje brenda vitit fiskal. Në raste të caktuara mund të thirreshin edhe mbledhje të jashtëzakonshme, nga çereku (1/3) i anëtarëve të kuvendit komunal. Mbledhjet e tij kryesoheshin nga kryetari i komunës, të vlefshme ishin nëse në mbledhje merrnin pjesë gjysma e anëtareve të pranishëm me të drejtë vote. Vendimet merreshin me shumicën e anëtarëve prezent, me përjashtim të rasteve kur kjo përcaktohej ndryshe me rregullore. Të gjithë anëtaret e kuvendit kanë pasur të drejtë të barabartë të votës, përveç kryesuesit, në rast të votave të barabarta (nenet 13, 14 dhe 15 të **Rregullores nr. 2000/45**).

Anëtarët e zgjedhur të kuvendit kanë mund të humbin mandatin në bazë të disa rrethanave të përcaktuara ligjore. Ato kanë pasur të bëjnë me sa vijon:

- nëse anëtari nuk nënshkruante deklaratën e betimit, një muaj pas zgjedhjes;
- nëse anëtari ka qenë i dënuar për vepër kundërvajtës të dënueshme me tre muaj burgim dhe nëse ka ekzistuar urdhri për burgim;

[93] *Rregullore e UNMIK-ut nr. 2001/9 për Kornizën kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme*, datë 15 maj 2001.

- nëse anëtari i kuvendit nuk ka marrë pjesë gjashtë muaj rresht në mbledhjet e kuvendit; dhe, së fundi,
- nëse anëtari ka humbur të drejtën për zgjedhje si anëtar i kuvendit komunal (neni 20 **Rregullores nr. 2000/45**).

Në kuadër te funksionimit të kuvendit komunal, si organe ndihmëse të kuvendit në këtë kohë kanë qenë edhe **komitetet**. Njëri ndër komitetet kryesore, i cili kryesohej nga kryetari i komunës dhe kishte për përgjegjësi kryesore propozimin e buxhetit, ka qenë **komiteti për politikë dhe financa**. Me qëllim të përfaqësimit të të drejtave të komuniteteve, në kuadër të kuvendit komunal ka funksionuar edhe **komiteti i përhershëm për komunitete dhe për ndërmjetësim**. Anëtarësia e këtij komiteti përbehej nga anëtarë të komuniteteve që jetonin në komunën përkatëse (neni 23 i **Rregullores nr. 2000/45**).

Përveç kuvendit te komunës, organ tjetër i qeverisjes komunale, siç u përmend më lartë, ka qenë edhe **kryetari i komunës**. Sipas rregullatives në fuqi, gjatë kohës së administrimit ndërkombëtar, kryetari zgjidhej nga ana e anëtarëve të kuvendit komunal dhe bëhej me vota te fshehta, me dy të tretat (2/3) e numrit të përgjithshëm te anëtarëve. Nëse asnjëri nga kandidatët në garë nuk fitonte numrin e nevojshëm të votave prej dy të tretave (2/3) e numrit te përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit komunal, ne dy raundet e para, dy kandidatët më të votuar shkonin në raundin e tretë. Kandidati që fitonte shumicën e votave në raundin e tretë, konsiderohej i zgjedhur. Mandati i kryetarit të komunës ka qenë i njëjtë me atë të kuvendit komunal (neni 24 i **Rregullores nr. 2000/45**). Përveç kryetarit, me procedurë të njëjtë, sikur kryetari, zgjidhej edhe zëvendëskryetari. Në komunat ku jetojnë një apo më shumë komunitete, zgjidhej një kryetar për komunitete (neni 25 i **Rregullores nr. 2000/45**). Me rastin e zgjedhjes, kryetari dhe zëvendëskryetari jepnin betimin para anëtarëve të kuvendit komunal (neni 26 i **Rregullores nr. 2000/45**). Kryetari mund të **shkarkohej** nëse nuk përmbushte kërkesat e **Rregullores nr. 2000/45**), që nënkuptonte mospërmbushje të kompetencave dhe autorizimeve të komunës. Shkarkimin e bënte kuvendi komunal, kryesues i të cilit ishte vetë kryetari komunës. Sa i përket shumicës se nevojshme për shkarkim, me **Rregulloren nr. 2000/45** përcaktohej se kryetari i komunës mund te shkarkohej me votat e me tepër se dy te tretave (2/3) të anëtarëve te kuvendit komunal. Në rast të shkarkimit të kryetarit të komunës, kryetari i ri zgjidhej jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga dita kur vendi i kryetarit kishte mbetur i lirë (neni 27 i **Rregullores nr. 2000/45**). Kompetencat e kryetarit te komunës, në kuadër të qeverisjes së atëhershme komunale, nuk ishin të caktuara në mënyrë decidive (taksativisht), ato ishin të lidhura kryesisht me ekzekutimin e vendimeve të kuvendit komunal, respektivisht me delegimin e mundshëm të kompetencave të cilat mund t'i bartë kuvendi komunal tek kryetari i komunës.

Një organ tjetër, përveç kuvendit komunal dhe kryetarit, ka qenë edhe **kryeshefi ekzekutiv** komunal. Kryeshefi zgjedhej nga kuvendi, me propozim te kryetarit të komunës. Ndër kompetencat kryesore të kryeshefit ka qenë **menaxhimi efikas i buxhetit komunal**. Përveç kësaj, kryeshefi ekzekutiv ka ushtruar detyrën e sekretarit të komunës, ka udhëhequr bordin e drejtorëve komunal, ka qenë përgjegjës për udhëheqjen efikase të çështjeve financiare dhe kryer detyra të tjera që i ishin caktuar me statutin e komunës. Kryeshefi ka qenë shef i personelit të komunës, kurse për punën e tij i ka raportuar kuvendit dhe kryetarit të komunës. Kryeshefi ka mund të shkarkohej vetëm për shkak të mos përmbushjes së detyrave të saj/tij, që përcaktoheshin me rregullore. Shkarkimi bëhej nga ana e kuvendit komunal (neni 30 i **Rregullores nr. 2000/45**).

Bordi i drejtoreve ka qenë organ kolegjial i komunës, i cili zgjedhej nga kuvendi komunal. Pjesë e tij kanë qenë drejtorët e drejtorive komunale. Secili statut i komunës përcaktonte numrin e drejtorive, të cilët bëheshin me automatizëm, me një votim formal në kuvend. Bordi ka ndihmuar kryetarin e komunës, kuvendin komunal si dhe kryeshefin ekzekutiv në kryerjen e detyrave të tyre të punës, që përcaktoheshin me rregullore dhe me statut. Drejtori i drejtorisë përkatëse dhe anëtarët e bordit të drejtoreve mund të shkarkoheshin vetëm nga kuvendi komunal, për mospërmbushje të detyrave (neni 31 i **Rregullores nr. 2000/45**).

Pjesë e organizimit të brendshëm të komunës ishte edhe **shërbimi civil komunal**, i cili udhëhiqej nga kryeshefi ekzekutiv i komunës (neni 34 i **Rregullores nr. 2000/45**). Një ndër çështjet e tjera, përveç organeve dhe qeverisjes komunale, të cilat ishin pjesë e rregullativës së atëhershme për qeverisjen komunale ishte edhe **buxheti i komunës**, që përbëhej prej burimeve të pushtetit qendror si dhe licencave dhe pagesave që i vinte komuna, të ardhurat nga pasuria e komunës dhe përqindja e gjobave (nenet 38 dhe 39 **Rregullores nr. 2000/45**).

Krejt kjo mëvetësi e komunës, megjithatë, ka qenë vetëm në dukje, sepse nëpër komuna ka ekzistuar funksioni i **administratorit ndërkombëtar**, i cili ka shërbyer si zbatues i pushtetit ndërkombëtar të UNMIK-ut, respektivisht të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (PSSP). Ky zyrtar ndërkombëtar, **administratori ndërkombëtar,** ka pasur një sërë autorizimesh, jashtëzakonisht të mëdha dhe të thella, kundrejt organeve dhe vetëqeverisjes komunale. Roli dhe pozita e tij në kuadër të rendit juridik kosovar të kohës, i bazuar në Rezolutën 1244, normohej në hollësi me **Rregulloren nr.1999/14 për emërimin e administratorëve rajonalë dhe komunalë** (Rregullorja nr. 1999/14).[94] Në rend të parë, administratori ndërkombëtar ka pasur për detyrë të siguroj se, në komunat e Kosovës, zbatohej Rezoluta 1244 dhe rregullat e tjera që ishin miratuar nga UNMIK-u. Mbi këtë bazë, **PSSP-ja**, si epror i administratorëve komunalë ndërkombëtarë, kishte kompetencën për anulim dhe rishikim të çdo vendimi të organeve të komunës, i cili nuk ishte në përputhje me **Rezolutën 1244**. Në realizimin e funksionit të vet, **PSSP-ja** ka pasur pushtetin e shkarkimit të çdo anëtari të kuvendit komunal, i cili gjatë kryerjes së detyrës mund të ketë bërë sjellje të këqija. Jo vetëm shkarkimin e anëtarëve individual të kuvendit komunal, por **PSSP-ja** ka mund të shpërndante edhe kuvendin komunal, nëse vlerësonte se kuvendi ishte duke ndërmarrë veprime të vazhdueshme, në kundërshtim me **Rezolutën 1244**. Ndër të tjera, PSSP-ja, në këtë linjë, ka mund të shpallë edhe zgjedhje të reja komunale (neni 147 i **Rregullores nr. 2000/45**). Nga këto autorizime, qartë shihet se administratori komunal nuk ka qenë veçse një zbatues i pushtetit që ka pasur **PSSP-ja**, në kuptim të zbatimit të **Rezolutës 1244** nga komunat e Kosovës, qytetarët dhe organet e tyre. Funksioni dhe autorizimet e këtij organi ndërkombëtar kanë qenë të ngjashme me ato të **guvernatorëve kolonialë nëpër ish-kolonitë e vendeve evropiane**, mbi të gjitha me qëllim të garantimit se vendimet e komunës ishin në pajtim me **Rezolutën 1244**. Forma më e dukshme e manifestimit të rolit të një guvernatori kolonial ka qenë fakti se ai/ajo kishte **të drejtë të suspendojë çdo vendim** që mund të konsiderohej si në kundërshtim me Rezolutën 1244. E njëjtë me këtë ka qenë edhe e drejta e administratorit komunal për **miratim të çdo emërimi ose largim nga puna** të nëpunësve të lartë dhe autorizimi për **kontroll të çdo emërimi** që ka pasur të bëjë me mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve. Kulmi i funksionit prej guvernatori kolonial ka qenë e drejta e administratorëve ndërkombëtarë për **miratim të buxhetit**, përfshirë edhe faktin se, vendimet për ndryshim apo miratim të buxhetit, nuk kanë hyrë në fuqi pa kundër firmën e saj/tij (neni 48 i **Rregullores nr. 2000/45**). Pas hyrjes në fuqi të **Kornizës Kushtetuese**, administratorët ndërkombëtarë komunalë, u quajtën **përfaqësues komunal të UNMIK**-ut (neni 31 i **Rregullores nr. 2000/45**).[95]

Kjo formë e qeverisjes lokale do të bëhet e paqëndrueshme në mënyrë graduale, veçanërisht përgjatë vitit 2005-2007, si pasojë e mosefikasitetit të tij dhe mungesës së legjitimitetit në sytë e popullsisë vendore. Në kuptim të kësaj, përkatësisht në rrethana të një qeverisje joefikase te UNMIK-ut, zgjidhja e statusit final te Kosovës u bë mjaftë e kërkuar nga faktorët vendor dhe ndërkombëtar. Në vitin 2006 filluan zyrtarisht bisedimet për zgjidhjen e statusit final të Kosovës, të njohura gjerësisht si **bisedimet e Vjenës**. Në këto bisedime, krahas statusit, kishin dominuar bisedimet për decentralizmin në Kosovë, i nisur në vitin 2005 si një pilot projekt në komunën e **Hanit të Elezit**. Çështja e decentralizimit kishte qenë një ndër temat kryesore në bisedimet e Vjenës për statusin final te Kosovës.[96] Përpjekjet në kuadër

[94] *Rregullore UNMIK-ut nr.1999/14 për emërimin e administratorëve rajonalë dhe komunalë,* datë 21 tetor 1999.

[95] Neni 2. *Rregullore e UNMIK-ut nr. 2003/11. Ndryshimi Rregullores nr.1999/14 për emërimin e administratorëve rajonalë dhe komunalë*, datë 22 maj 2001.

[96] Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar. Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për Pavarësi* (KOHA: Prishtinë, 2011), fq. 335.

të bisedimeve të Vjenës kanë qenë të përqendruara rreth numrit dhe përkufizimit territorial dhe kompetencave te komunave kosovare.

Pas shpalljes së pavarësisë së vendit më 17 shkurt 2008, zhvillimi i qeverisjes lokale kishte kaluar në një faze tjetër juridike, për shkak të hyrjes në fuqi të KKos me 15 qershor 2008 dhe infrastrukturës se re ligjore. Që nga hyrja në fuqi e KKos, Kosova krijoi bazën kushtetuese dhe ligjore për vetëqeverisje lokale, ku njësia themelore, sikur edhe gjatë periudhës së administrimit ndërkombëtar nga UNMIK, mbeti komuna. Në përmbajtje, megjithatë, komuna e pavarësisë së Kosovës dhe ajo e kohë së **UNMIK**-ut kishin dallime substanciale: tanimë komuna, organet dhe qytetarët e saj, kishin **legjitimitet** të plotë, jo vetëm **legalitet**, sepse shërbimet publike jo vetëm që ishin afruar më shumë me qytetarin, por edhe drejtimi me komunën ishte bërë më i prekshëm dhe më afër brengave dhe orientimeve politike, kulturore, sociale, ekonomike dhe të tjera të qytetarit të Kosovës. Në kontekst kronologjik, megjithatë, procesi i decentralizimit të pushtetit shtetëror dhe autoritetit publik në vend kishte tendencë të theksuar të marrjes së premisave etnike, joqytetare, por të bazuar në përkatësinë etnike të shtetasve të Kosovës. Kjo vinte në shprehje në veçanti te komuniteti serb, përpjekjet e të cilit në vazhdimësi kanë qenë për të sfiduar legjitimitetin e brendshëm dhe të jashtëm të shtetit të ri të Kosovës që u krijua në ditën e 17 shkurtit 2008. Kjo tendencë nuk vërehej te komunitetet tjera joshqiptare. Gjendjen aktuale lidhur me këtë komunitet dhe autonominë asimetrike që e synon brenda Kosovës, si një fazë për një projekt tjetër politik më serioz kundër shtetësisë së Kosovës, e kemi sqaruar gjerësisht më sipër në kontekstin e diskutimit për **MO** dhe dialogut Kosovë-Serbi në dritën e regjionalizmit brenda Kosovës.[97] Përpjekjet e parreshtura të serbëve lokalë dhe të Serbisë si shtet për instalimin e komunave dhe një autonomie të komunave serbe në Kosovë, ka qenë dhe ngelet një ndër aspektet më sfiduese të zbatimit të reformave lokale në **Kosovë**. Kjo tendencë, pra, kishte shkuar paralel jo vetëm me bisedat e **Vjenës** për statusin e Kosovës, por datonte edhe më herët se fillimi i këtyre bisedimeve: decentralizimi në Kosovë ishte një proces politik, të cilit qysh pas përfundimit të luftës dhe instalimit të misionit të UNMIK-ut i ishte kushtuar kujdes i veçantë. Nga fundi i vitit 2002, deri në fillim të vitit 2004, shumë organizata vendore dhe ndërkombëtare, si dhe aktorë të tjerë, ishin përfshirë në këtë proces. Në fund të vitit 2004, nën ndikimin e bashkësisë ndërkombëtare, Kosova hartoi **Planin strategjik për decentralizimin** (PS 2004).[98] Vetëm në vitin 2005, megjithatë, u arrit të zbatohej, për herë të parë, plani për decentralizmin dhe atë përmes themelimit të pesë (5) **pilot njësive komunale**: Hani i Elezit, Mamusha, Parteshi, Juniku dhe Graqanica.[99] Ky proces kësisoj i decentralizimit, i nisur në këtë mënyrë, domosdo që ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë edhe në përcaktimin e modelit të qeverisjes lokale, duke mundësuar kështu **krijimin gradual të një statusi të veçantë për komunat me shumicë serbe**.

Ky proces, procesi i decentralizmit, të cilin akoma e kemi sot (prill 2023), ka marrë formën e tij në **bisedimet e Vjenës** për statusin e Kosovës. Ky model i decentralizimit u bart më pas në Aneksin III të Planit Ahtisari dhe u përbrendësua në dispozitat e KKos. Ky **model ahtisarian i decentralizimit**, më shumë ka qenë dhe ngelet si një decentralizim i krijuar mbi baza etnike që në të vërtetë favorizon vetëm një komunitet - komunitetin serb në Kosovë. Se kjo është kështu, bëhet e qartë që në hyrje të **Aneksit III** të **Planit Ahtisari**, i cili sqaron se, ndër të tjera, modeli i decentralizimit dhe qeverisjes lokale në Kosovë ka për bazë adresimin e shqetësimeve të serbeve të Kosovës dhe komuniteteve të tjera jo shumicë. Sikundër u vu në dukje, KKos ka përbrendësuar këtë frymë të Planit Ahtisari, që për pikë referimi ka koncesionet ndaj serbëve lokal në sferën e qeverisjes lokale, koncesione që u realizuan përmes krijimit të komunave të reja serbe me tendencë lidhjen e tyre territoriale me qëllim të formimit të një regjioni autonom serb në Kosovë, tani për tani, gjithnjë me synim tjetër përfundimtar në dëm të shtetësisë së Kosovës. Sipas modelit të decentralizimit që mishërohet në Aneksin III të **Planit Ahtisari**, modeli i decentralizimit ngërthen disa **karakteristika unike** që nuk gjenden askund në regjionin e Ballkanit, të cilat janë për sa vijon:

---

97 Cf. më shumë në seksionin 6.1, **supra**, në këtë pjesë të librit.

98 Besnik Tahiri, *Politika e Decentralizimit në Kosovë-Ndikimi në reformën e vetëqeverisjes Lokale* (Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale: Prishtinë, qershor 2008), fq. 30-31.

99 Ibid., fq. 31.

- e para, ekziston themelimi i komunave me shumicë të vetëm një komuniteti – shumicës serbe;
- e dyta, kompetencat e zgjeruara vetjake të komunave vlejnë vetëm për disa prej komunave kosovare komunave;
- e treta, e drejta e komunave serbe që të zbatojnë planprogramet e Republikës së Serbisë nuk vlen për komunitetet tjera joshumicë;
- e katërta, e drejta për universitet serb ne komunën e Mitrovicës se Veriut, që gjithashtu nuk ekziston për komunitetet tjera joshumicë në Kosovë;
- e pesta, e drejta e bashkëpunimit të komunave në Republikën e Serbisë përmes marrëveshjeve të veçanta, që nuk njihet për komunitetet tjera joshumicë në Kosovë;
- e gjashta, e drejta e pranimit te donacioneve drejtpërdrejtë nga Republika e Serbisë (Aneksi III, nenet: 4,7,8,10,11,12).

Shprehjen e tyre më të qartë, këto karakteristika të qeverisje lokale në favor të serbëve, me tendencën e qartë të kthimit të tyre në autonomi politiko-territoriale, si një formë më e lartë e regjionalizmit asimetrik të Kosovës, e gjejnë në nenin 81 të KKos. Në ndërkohë që dispozitat tjera të kapitullit të tretë të KKos, sanksionojnë në mënyrë universale tipin e demokracisë kushtetuese kosovare, **demokracinë konsonsociacionale**, ku qeverisja lokale i shërben qëllimit të përgjithshëm të kushtetutëbërësit kosovar për përfaqësim të të gjitha komuniteteve në sistemin kushtetues nacional, neni 81 i **KKos** efektivisht paraqet një dispozitë kushtetuese që favorizon dhe mbronë ekskluvishit komunitetin serb të Kosovës. Ky nen, që normon legjislacionin me interes vital, përcakton për sa vijon:

"1. Për miratimin, ndryshimin ose shfuqizimin e ligjeve në vijim, kërkohet vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë, si dhe të shumicës së deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë, të cilët mbajnë vende të garantuara për përfaqësuesit e Komuniteteve që nuk janë shumicë:
(1) ligjet të cilat ndryshojnë kufijtë e komunave, themelojnë ose shuajnë komuna, përkufizojnë shtrirjen e pushteteve të komunave dhe pjesëmarrjen e tyre në marrëdhëniet ndërkomunale dhe tejkufitare;
(2) ligjet të cilat zbatojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, me përjashtim të atyre të përcaktuara me kushtetutë;
(3) ligjet për përdorimin e gjuhëve; (4) ligjet për zgjedhjet lokale;
(5) ligjet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe zonave të veçanta të mbrojtura;
(6) ligjet për liritë fetare ose për marrëveshjet me komunitetet fetare; (7) ligjet për arsimin;
(8) ligjet për përdorimin e simboleve, përfshirë simbolet e komuniteteve dhe për festat publike". (neni 81.1 i **KKos**).

Për të qenë të sigurtë në sigurimin dhe garantimin e këtyre të drejtave kushtetuese, kushtetututëbërësi kosovar ka vënë një **klauzolë shpëtimi** ("saving clause") për komunitetin serb, që gjenden në dispozitën e paragrafit të dytë të nenit të njëjtë. Sipas kësaj klauzole, "[...] Asnjëri nga ligjet me interes vital, nuk mund t'i nënshtrohet referendumit" (neni 81.2 i KKos).

Të gjitha këto veçori, sikundër mund të shihet, burojnë nga **cilësia themelore e modelit ahtisarian të decentralizimit** - e drejta për themelim të të ashtuquajturave komuna me shumicë serbe, duke përjashtuar të gjitha komunitetet tjera në vend. Kjo është veçoria bazike e decentralizmit në Kosovë. Të gjitha veçoritë tjera, të cilat i kemi theksuar më sipër, janë të lidhura drejtpërdrejtë dhe ekskluzivisht me funksionimin e komunave me shumicë serbe, të cilat, siç u tha, u krijuan si komuna të reja. Një komunë e vetme që mund të thuhet se tani për tani (prill 2023) përbën përjashtim, është **Komuna e Mamushës**, me shumicë turke. Statusi i komunave me shumicë serbe, kompetencat e zgjeruara që iu takojnë, në veçanti lidhja me **Republikën e Serbisë**, të cilat nuk i gëzon **Komuna e Mamushës**, e bëjnë decentralizimin në Republikën e Kosovës, një model decentralizimi i cili funksionon, përveç mbi parime të tjera të pranueshme, edhe mbi parime etnike, në fakt, dhe mbi të gjitha, mbi parime të pastra etnike të një komuniteti – komunitetit serb të Kosovës. Ky decentralizim, megjithatë, operon brenda

KKos dhe ligjeve të vendit, së paku deri në momentin e shkrimit të këtyre rreshtave (prill 2023), bazuar në **burimet juridike të qeverisjes lokale** që diskutohen më poshtë. Fakti që kjo qeverisjes ndërlidhet fuqishëm me pozitën e komuniteteve në nivelin lokal, me favorizim të theksuar të komunitetit serb, bën që qeverisja lokale në Kosovë të jetë **një problem permanent i sistemit kushtetues nacional,** sepse mund të shërbej si një burim i pashterueshëm i nacionalizmit etnik, në veçanti i atij serb, dhe të çoj në defunksionalizimin e Shtetit të Kosovës. Posedimi edhe i një veçorie tjetër të rëndësishme, që ka të bëjë me **mbrojtjen kushtetuese të autonomisë lokale përmes mekanizmave të caktuar**, të cilat i siguron KKos, vetë për veti nuk garanton funksionalitetin e shtetit të Kosovës në tërë territorin nacional. Kjo veçori është e përbashkët për krejt modalitetet e vetëqeverisjes lokale kosovare, por kur vjen puna të **kërkesat serbe për autonomi të plotë**, të cilat vështirë se mund të ndërpriten dhe pengohen nga pushteti qendror në Kosovë, një mbrojtje e tillë ngelet joefektive dhe e vlefshme vetëm për pjesën tjetër të qeverisjes lokale në Kosovë. Kjo për faktin se, në momentin e përligjësimit të **Statutit të A/BKS**, bazuar në zotimin e marrë me **MO**, ngelet praktikisht joefektiv çdo autorizim dhe kompetencë e pushtetit qendror sa i përket kontrollit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së veprimit të autonomisë serbe në vend.

Një veçori tjetër që është e përbashkët për qeverisjen lokale në Kosovë ka të bëj me **të drejtën e komunave për të qenë palë në GJKRKS**, me qellim të mbrojtjes së autonomisë financiare dhe përgjegjësive të tjetra të komunave nga inkursioni i pushtetit qendror. "Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt" (neni 113.4 i KKos).

Faza e re e zhvillimit të qeverisjes lokale, e cila tani operon brenda kornizave juridike të një shteti sovran dhe të pavarur, nënkupton që edhe përmbajtja e saj të jetë më ndryshe shumë se në kohën e administrimit ndërkombëtarë. Kjo për shkak se, në këtë frymë, **KKos** ka vënë themelet e qeverisjes së re lokale në kapitullin e dhjetë të saj. Njëri ndër parimet kushtetuese të qeverisjes lokale në Kosovë, sipas **KKos** është **zgjedhja e organeve lokale drejtpërdrejtë nga qytetarët** (neni 123.2 i **KKos**). Përmes parimeve kushtetuese, **Republika a Kosovës** ka përqafuar frymën e **KEVL-së**, duke marre obligim edhe zbatimin e tyre në kuadër të rendit të saj juridik (neni 123.3 i **KKos**). Disa parime të tjera të qeverisjes lokale, të cilat i promovon **KKos**, janë edhe **parimi i qeverisjes së mirë**, **transparencës**, **efikasitetit**, **efektivitetit** dhe **ofrimit të shërbimeve publike për qytetarët**. Parimet e qeverisjes lokale të mishëruara në KKos, ndër të tjera kërkojnë që, në kuadër të qeverisjes lokale, kujdes të kihet për brengat specifike të komuniteteve, që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës (neni 123.4 i **KKos**). Ky fakt fuqizon argumentin e mësipërm për veçoritë e një decentralizmi etnik, por që në praktikë ka çuar në një pozitë të fortë të komunitetit serb në Kosovë.

Njësi themelore e vetëqeverisjes lokale, megjithatë, edhe më tej ngelet **komuna**. Organizimi dhe kompetencat e komunës rregullohen me ligj (neni 12 i KKos). Ky përcaktim kushtetues përbën njërin ndër parimet themelore të rregullimit kushtetues të pushtetit, në kuptimin vertikal. Pjesëmarrja aktive e qytetarëve në kuadër të organeve komunale, është një ndër përcaktimet kryesore kushtetuese që ka të bëjë me organizimin dhe funksionimin e qeverisjes lokale në vend: "Njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës është komuna. Komunat gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale" (neni 124.1 i **KKos**). Mënyra e organizimit, kufijtë komunalë dhe mënyra e funksionimit te komunave është e rregulluar me ligj të veçantë (neni 124.2 i KKos). Komunat kanë kompetenca vetjake, të zgjeruara si dhe kompetenca te deleguara, te cilat përcaktohen detajisht me ligj (neni 124.3 i **KKos**). Në praktikë, këtu bëhet fjalë për komunat me shumice serbe, të cilat i kanë kompetencat e zgjeruara. Vështirë mund të besohet që këto kompetencat t'i gëzojnë komunat tjera me shumicë joshqiptare dhe joserbe (sic!). Bashkëpunimi ndërkomunal dhe ndërkufitar i komunave dhe e drejta e tyre për këtë bashkëpunim, përbën njërën ndër çështjet që e garanton **KKos**. Kjo e drejtë në mënyrë të detajuar

rregullohet me ligj (neni 124.4 i **KKos**). Komunat kanë të drejtë të vendosin, të caktojnë, të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyrat e veta si dhe të marrin fonde nga qeveria qendrore, në pajtim me ligjin (neni 124.5 i **KKos**). Më këtë garantohet autonomia financiare e komunave të Kosovës. Aktiviteti normativ i komunës dhe nxjerrja e akteve të saj është një proces i domosdoshëm, me qëllim të qeverisjes së tyre. Në këtë kuptim, të gjitha komunat obligohen që të respektojnë kushtetutën dhe ligjin dhe të zbatojnë vendimet gjyqësore (neni 124.6 i **KKos**). Me qëllim të mbrojtjes së parimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, organet qendrore mund t'i rishikojnë aktet e komunave, sa i përket ushtrimit të kompetencave të komunës, si dhe duke u kufizuar ne sigurimin e përputhjes se akteve te komunës me KKos dhe ligjet e tjera te aplikueshme në Republikën e Kosovës (neni 124.7 i **KKos**).

Nga shtjellimet deri këtu, mund të përfundohet me lehtësi se KKos dhe ligjet sektoriale që normojnë vetëqeverisjes lokale, segmentet e saj të ndryshme, përfaqësojnë burimet primare të qeverisjes lokale në Kosovë. Ky përfundim, megjithatë, nuk reflekton me saktësi esencën e burimeve të qeverisjes lokale në vend, që është kuptimisht më i gjerë, sepse përfshinë edhe akte të tjera juridike. E kemi fjalën në veçanti për **marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare** (sepse ato që figurojnë në nenin 22 të **KKos** përfaqësojnë dispozita dhe norma kushtetuese, me fuqi të njëjtë si çdo normë e dispozitë kushtetuese në Kosovë), **vendimet e GJKRKS**, **statutet e komunave** dhe rregulloret e udhëzimet administrative të nxjerra nga ministria kosovare përgjegjëse për qeverisje lokale.

KKos, si akti më i lartë në një shtet, pashmangshëm edhe në rastin e Kosovës përbën njërin ndër burimet kryesore formale të qeverisjes lokale. KKos konsiderohet burim i së drejtës së qeverisjes lokale, sikundër u pa, për arsye se përcakton qartë parimet themelore të qeverisjes lokale në kapitullin e dhjetë i **KKos**, por edhe në dispozitat e tjera të saj. Të gjitha ligjet dhe burimet e tjera të së drejtës së qeverisjes lokale në Kosovë. Për më tepër, komunat gjatë gjithë punës dhe aktivitetit të tyre normavënës, janë të detyruara të respektojnë KKos, duke u kujdesur që aktet e tyre të jenë në përputhje jo vetëm me KKos, por edhe me ligjet e aplikueshme. Këtyre qëllimeve iu shërben **kontrolli i kushtetutshmërisë** së aktit më të lartë juridik të komunës dhe **kontrolli i ligjshmërisë** së akteve dhe veprimeve të organeve komunale nga neni 113.2 (2) lidhur me nenin 124.7 të **KKos**.

Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në Republikën e Kosovës kanë epërsi ndaj ligjeve të aplikueshme dhe si të tilla përbëjnë burim formal të së drejtës. Në rastin konkret, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, që **prekin segmente të caktuara kushtetuese të qeverisjes lokale**, përfaqësojnë burime të aplikueshme të së drejtës së qeverisjes lokale. Një burim i tillë në Kosovë mund të konsiderohet MA 2013, që normon normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Një pjesë e tekstit të MA 2013 në esencë prek çështje që kanë të bëjnë me qeverisjen lokale, respektivisht themelimin dhe funksionimin e **A/BKS**. Status të njëjtë kanë edhe **MA 2015** si dhe **MO** dhe **Plani i Zbatimit**. Si burim i së drejtës së qeverisjes lokale mund të jetë edhe çfarëdo marrëveshje ndërkombëtare, e ratifikuar sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të **KKos**, që në materien e saj rregullon çështje që kanë të bëjnë me qeverisjen lokale dhe të komunave.

Vendimet e GJKRKS përbëjnë një burim formal të së drejtës për faktin se përmes tyre bëhet interpretimi përfundimtar i KKos. Në kontekstin e qeverisjes lokale, vendimet e GJKRKS janë burime formale, për aq sa të njëjtat interpretojnë dhe prekin materien kushtetuese që ka të bëj me organizimin dhe funksionimin e qeverisjes lokale. Në praktikën e deritanishme të GJKRKS ka pasur raste kur janë nxjerrë vendime të cilat kanë pasur për objekt trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me qeverisjen lokale. Një ndër rastet e tilla, në të cilat janë prekur çështjet që kanë të bëjnë me aspektet e qeverisjes lokale, ka qenë rasti **Qemajl Kurtishi dhe Kuvendi Komunal i Prizrenit** (Rasti KO 01/09).[100] Çështja thelbësore ka pasur të bëjë me nenin 7 të Statutit të Komunës së Prizrenit, i cili, sipas aktgjykimit të GJKRKS, kishte

[100] *Aktgjykim në rastin KO 01/09. Qemajl Kurtishi dhe Kuvendi Komunal i Prizrenit*. Prishtinë, datë: 18 mars 2010. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Ref. Nr. AGJ 07/10.

qenë në kundërshtim me KKos. kushtetutën. Kërkesën në **Rastin KO 01/09** e ka parashtruar zt. Qemajl Kurtishi, zëvendëskryesues i Kuvendit Komunal të Prizrenit, më datë 22 prill 2009. Ai kishte pretenduar se neni 7 i Statutit të Komunës së Prizrenit cenonte nenet 3.1, 6.1, 58.1 dhe 59.1 të **KKos.** Esenca e kësaj kërkese ka pasur të bëjë me simbolin (emblemën) e **Komunës se Prizrenit**, e cila, sipas kërkuesit, zt. **Qemajl Kurtishi**, kishte përmbajtje që nuk relflektonte krejt komunitetet e kësaj komune por vetëm shqiptarët. Kjo sepse, gjithnjë sipas kërkesës, emblema kishte vetëm vitin 1878, vitin e Lidhjes së Prizrenit, ngjarjes historike me të cilën nis Rilindja Shqiptare. Për pasojë, kërkesa e zt. **Qemajl Kurtishi** pretendonte se, kjo emblemë ishte në kundërshtim me nenet e mësipërme të **KKos** dhe shkelte të drejtat e komuniteteve jo shumicë në këtë komunë. **GJKRKS** kishte qëndrim të njëjtë me kërkuesin, duke arsyetuar se emblema e Komunës së Prizrenit duhej të ishte simbol i të gjithë qytetarëve të Prizrenit. Ndër të tjera, në ketë rast GJKRKS ka konstatuar se: "kur komuna ka vendosur të shpallë emblemën që promovon trashëgiminë dhe traditën shqiptare pa vëmendje ndaj komuniteteve të tjera, ajo ka shkelur të drejtat e tyre statusore dhe kushtetuese" (parag. 46 në **Rastin KO 01/09**). Kjo ishte kësisoj, gjithnjë sipas GJKRKS, për shkak se, nuk mund te arrihet pjesëmarrja e komuniteteve në jetën publike, sociale, ekonomike dhe kulturore të një vendi, nëse simboli i përbashkët i asaj shoqërie nuk përfaqëson të drejtat e komuniteteve, por në vend të kësaj injoron të drejtat e komuniteteve joshumicë (parag. 52 në **Rastin KO 01/09**). Emblema e Komunës se Prizrenit duhet të paraqesë simbolin e shoqërisë shumetnike, duke përfaqësuar komunitetin shumicë dhe atë joshumicë në këtë komunë (parag. 53 në **Rastin KO 01/09**). **Komuna e Prizrenit**, përmes përmbajtjes së emblemës (sipas nenit 7 të Statutit), ka shkelur të drejtat e komuniteteve joshumicë, për të ruajtur, mbrojtur dhe promovuar identitetin e tyre (pika e dytë e pjesës operative të aktgjykimit në **Rastin KO 01/09**). GJKRKS e kishte obliguar Komunën e Prizrenit që të ndryshonte nenin 7 të Statutit të saj, duke marrë parasysh të gjitha gjetjet që i kishte konstatuar në rastin konkret.

Një rast tjetër i rëndësishëm që është vendosur në GHKKos, me relavancë për qeverisjen lokale, respektivisht për ushtrimin e kompetencave te komunave në fushën e urbanizmit, ka qenë **Rasti Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit** ("Rasti Fadil Hoxha dhe të tjerët").[101] Palët të cilët e kishin parashtruar këtë kërkesë, kontestonin vendimin e Kuvendit Komunal të Prizrenit, për ndryshimin e planit urbanistik të vitit 1983, që në vend të zonave të gjelbëruara, të ndërtoheshin banesa të larta, të planifikuara për familjet e dëshmorëve dhe rasteve sociale. Në këte rast, GJKRKS kishte vendosur se Kuvendi Komunal i Prizrenit, përmes vendimit i cili ishte kontestuar nga palët, kishte shkelur të drejtën për përgjegjësinë e institucioneve për mjedisin jetësor, sipas nenit 5.2 të KKos, i cili nen përcakton si në vijim: "Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton".

Një rast tjetër që ishte vendosur nga GJKRKS, që nuk ishte si **Rasti KO 01/09** dhe as **Rasti Fadil Hoxha dhe të tjerët**, dhe që gjithashtu prekte parimet kushtetuese të qeverisjes lokale, por në një mënyrë tjetër, ka qenë vendimin e **GJKRKS** të vitit 2015 lidhur me **A/BKS**. Në këtë rast, GJKRKS kishte vendosur se **A/BKS** dhe mënyra e funksionimit të tij, sipas MA 2013, ishte në kundërshtim me disa nene të KKos. Në nenet kontestuese ishin edhe ato qe në KKos rregullojnë organizimin dhe funksionimin e qeverisjes lokale (pra, kapitulli i dhjetë i saj).[102].

---

[101] *Aktgjykim. Rasti Nr. KI 56/09. Parashtruesit: Fadil Hoxha dhe 59 te tjerë kundër Kuvendit Komunal t*ë *Prizrenit.* Prishtinë, datë: 18 mars 2010. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Ref. Nr. AGJ 07/10.

[102] *Aktgjykim. Rasti nr. KO 130/15. Parashtrues: Presidentja e Republikës së Kosovës lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe ne Kosovë -Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore" me frymën e Kushtetutës, me nenio 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës*. Prishtinë, 23 dhjetor 2015. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës**. Ref.: Nr. AGJ 877/15.

Ligjet, sikurse edhe KKos, përbëjnë një burim të rëndësishëm të së drejtës së qeverisjes lokale në Kosovë. Parimet e qeverisjes lokale dhe organizimi i saj, nuk do të mund të zbatoheshin në mungese të ligjeve, të cilët rregullojnë aspekte të funksionimit dhe organizimit të qeverisjes lokale. Ligjet të cilat aktualisht rregullojnë organizimin dhe funksionimin e qeverisjes lokale në Republikën e Kosovës përfshijnë:

- Ligjin për vetëqeverisje lokale;
- Ligjin për zgjedhjet lokale;
- Ligji për financat e pushtetit lokal;
- Ligji për kufijtë administrativ të komunave;
- Ligji për bashkëpunim ndërkomunal;
- Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës; dhe
- Ligji për kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën.

Statutet e komunave definohen si akte juridike, që miratohen nga komuna, në pajtim me KKos dhe legjislacionin qendror që rregullon organizimin e brendshëm të komunës. Në kuptimin e hierarkisë së brendshme të akteve të komunës, statuti është akti më i lartë, pas KKos dhe ligjeve. Statuti si akt i qeverisjes se komunës dhe njëherësh edhe si burim i se drejtës së qeverisjes lokale, nuk ka efekt në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës: ai prodhon efekt juridik vetëm brenda territorit të komunës përkatëse, për shkak se, secila komunë i ka specifikat e saj të qeverisjes dhe të organizimit të brendshëm. Me statutin e komunës rregullohen disa çështje të rëndësishme, mes tjerash çështjet për si vijon:

- përgjegjësitë, funksionet dhe kompetencat e komunës;
- organet e komunës si dhe të shërbimit civil;
- mbledhja konstituive e kuvendit si dhe mbledhjet e rregullta të komunës përkatëse;
- të drejtat dhe detyrat e anëtarëve te kuvendit;
- të drejtat dhe detyrat e kryetarit dhe nënkryetarit të komunës si dhe përgjegjësitë e tyre;
- komitetet në kuadër të komunës përkatëse;
- administrata komunale;
- administrimi financiar i komunës;
- pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e qytetarëve në vendimmarrje etj.

Aktet nënligjore të komunës, të kuvendit komunal, por edhe ato të organeve qendrore, të cilat i nxjerr ministria përkatëse për qeverisje lokale, janë burime të së drejtës së qeverisjes lokale. Kuvendi komunal, por edhe kryetari i komunës përkatëse, brenda kompetencave të tyre kanë të drejtë të miratojnë akte të caktuara nënligjore. Me qëllim të qeverisjes së mirë të komunave, në pamjaftushmëri të normave ligjore, organet qendrore miratojnë **akte nënligjore** (udhëzime administrative dhe rregullore), të cilat vlejnë për të gjitha komunat. Si akte nënligjore te cilat janë nxjerrë nga organet qendrore dhe që janë aktualisht në fuqi në Republikën e Kosovës mund të përmenden:

- Udhëzimin administrativ për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin në mes të komunave me fshatrat, lagjet dhe vendbanimet urbane;
- Udhëzimi administrativ për zbatimin e përgjegjësisë së ministrisë përkatëse për punët e pushtetit lokal në lidhje me monitorimin dhe mbikëqyrjen e komunave;
- Rregullorja për sistemin e menaxhimit të performancës së komunave;
- Rregullorja për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës;
- Udhëzimi administrativ për standardet minimale të konsultimit publik në komuna etj.
- Udhëzimi administrativ për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane etj.

Në vijim trajtojmë në një mënyrë të detajuar organizimin dhe funksionimin e qeverisjes lokale, sipas ligjeve dhe akteve të tjera juridike të aplikueshme në Republikën e Kosovës, disa prej të cilave u dhanë më sipër si tituj, që normojnë materien e qeverisjes lokale në segmente të dhëna. Nga shtjellimi në vijim shpalosen aspektet konkrete të veçorive të qeverisjes lokale në vend, fizionomia e saj dhe mënyra e funksionimit. Nga ky shtjellim dhe krahasimi i materies së qeverisjes lokale në vendet përreth Kosovës, lehtë mund të arrihet në përfundim se konceptualisht bëhet fjalë për zgjidhje mjaft të përafërta kushtetuese dhe ligjore. Për pasojë, çdo elaborim i yni i fizionomisë së organeve të komunës, këshillave komunalë, të kompetencave të tyre, organizimit dhe funksionimit të sistemit komunal në Kosovë në përgjithësi, bazohet në dispozitat e akteve si më sipër juridike që aktualisht janë në fuqi (prill 2023). Këto nuk hyjnë aktet juridike individuale të organeve qendrore si dhe akte të tjera të organeve të pushtetit qendror në Kosovë që normojnë sferën e qeverisjes lokale: shtjellimet tona bazohen vetëm në ato akte të pushtetit qendror që kanë vlefshmëri të njëkohshme për të gjitha komunat e vendit.

Ashtu siç u tha, përcaktim kushtetues i Kosovës ka qenë që, njëjtë si në vendet tjera të ish-Jugosllavisë, **komuna** të përfaqësojnë njësinë themelore të vetëqeverisjes lokale. Ajo përbëhet nga një territor dhe komunitet i caktuar i qytetarëve. As KKos dhe as ligjet sektoriale që rregullojnë jetën dhe punën në njësinë e vetëqeverisjes komunale që quhet komunë, nuk përcaktojnë kriterin etnik si bazë themelore të qeverisjes lokale. Nga përcaktimi kushtetues dhe ligjor se qeverisja ka të bëjë me një komunitet të caktuar të qytetarëve, pa specifikim të kriterit etnik, gjuhësor, fetar dhe tjetër, nënkuptohet që komuna, për të qenë funksionale, ka një komunitet të qytetareve që janë banorë dhe shtetas të Kosovës, pra që jetojnë në një territor të caktuar administrativ, i cili përcaktohet me ligj, siç është **Ligji për kufijtë e komunave**. Si e tillë, komuna ka statusin ligjor të personit juridik, që nënkupton se ka të drejtë të padis dhe mund të paditet, të menaxhoj me pasurinë e pronën e komunës, të lidhë kontrata, të punësoj stafi, krejt kjo në cilësinë e personit juridik nga e drejta publike e Kosovës, instrument kryesor i së cilës, përveç KKos, është **Ligji për Vetëqeverisje Lokale**. Përveç territorit dhe qytetarëve që jetojnë brenda një territori, komuna ka edhe simbolet e saj, te cilat caktohen, miratohen dhe ndryshohen nga ana e kuvendit të komunës me një shumicë prej dy të tretave (2/3) të këshilltarëve të kuvendit të komunës.

Sa i përket gjuhëve zyrtare, duhet sqaruar se gjuhë zyrtare në të gjitha komunat është gjuha shqipe dhe gjuha serbe (alfabeti cirilik). Ky është një garancion kushtetues nga neni 5.1 i KKos që përcakton: "Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe". Në rast se në një komunë, një bashkësi e caktuar përbën 5% të popullsisë, gjuhë zyrtare në atë komune është gjuha e asaj bashkësie (komuniteti). Gjuha turke, boshnjake dhe ajo rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel. Ky përcaktim nga **Ligji për Vetëqeverisje Lokale** vë në jetë klauzolën kushtetuese nga neni 5.2 i KKos, që thotë si vijon: "Gjuha Turke, Boshnjake dhe ajo Rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligj". Kjo shpjegon se përse, ta zëmë, në Komunën e Prizrenit, gjuhë zyrtare në nivel lokal është edhe gjuha turke.

Komuna ka organet e saj, të cilat funksionojnë sipas ligjit dhe kanë të drejtë të nxjerrin akte të caktuara. Të gjitha aktet komunale, të cilat nxirren nga organet e saj duhet të jenë në pajtim me **KKos** dhe **ligjet** e **Shtetit të Kosovës**. Sipas **Ligji për Vetëqeverisje Lokale**, si **organe kryesore** të komunës janë kuvendi dhe kryetari i komunës. Ky i fundit, sipas si një organ inokos, ka të drejtë të nxjerr vendime dhe urdhëresa, gjithnjë brenda kompetencave që ka. Organi i parë, **kuvendi i komunës**, gjithashtu sa i përket rregullimit të autorizimeve që ka me KKos dhe ligj, ka të drejtë të nxjerr aktet për sa vijon:

- statutin e komunës;
- rregulloren e punës;
- rregulloret komunale; dhe

- akte te tjera të nevojshme per funksionimin e komunës.

Sipas KKos dhe ligjit, komuna ka të drejtë të menaxhojë pronën e saj dhe çështjet e pronës së komunës. Mënyra e menaxhimit të pronës, rregullohet me ligj të veçantë, me **Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës**

Kuvendi i komunës, si **organi më i lartë në kuadër të komunës**, zgjidhet drejtpërdrejtë nga qytetarët e komunës përkatëse. Mandati i anëtarëve të kuvendit komunal është katër (4) vjet. Zgjedhjet për kuvendin komunal mbahen çdo katër (4) vjet. Zgjedhjet nuk mund të mbahen më herët se 60 ditë para përfundimit të mandatit, por jo më vonë se tridhjetë (30) dite pas përfundimit të mandatit të kuvendit komunal. Ne rast të shpërndarjes së kuvendit të komunës, zgjedhjet e parakohshme lokale shpallen nga Presidenti Republikës, jo më vonë se dhjetë (10) ditë pas shpërndarjes. Të drejtë kandidimi për anëtarë të kuvendit komunal kanë të gjithë qytetarët e komunës që kanë arritur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare dhe që i plotësojnë kushtet për të ushtruar të drejtën aktive të zgjedhjes sipas **Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë**. Subjekti politik paraqet listën e kandidatëve për kuvend komunal, për certifikim, duke pasur parasysh numrin e anëtarëve të kuvendit komunal si dhe **kuotën gjinore**. Në secilin kuvend komunal, ndarja e vendeve në kuvend bëhet duke pasur parasysh numrin e përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit komunal përkatës.

Pasi të marrin mandatin nga Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), anëtarët e kuvendit komunal betohen duke përsëritur tekstin si në vijim: “Betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t’i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar i kuvendit të komunës së _____, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”. Ata që nuk nënshkruajnë mandatin ose nuk japin betimin e tyre, brenda afatit prej një (1) muaji pas certifikimit të rezultateve nga KQZ-ja, pushojnë së qeni anëtarë të kuvendit komunal. Numri i anëtarëve duhet të jetë në proporcion me numrin e qytetarëve në kuadër të komunës përkatëse. **Ligji për Vetëqeverisen Lokale** çështjen e anëtarëve te kuvendit te komunës e rregullon si në vijim:

- nëse komuna i ka deri ne 10.000 qytetarë, kuvendi i asaj komune përbëhet prej 15 anëtarëve;
- nëse komuna i ka prej 10.000 deri 20.000 qytetarë, kuvendi i asaj komune përbëhet prej 19 anëtarëve;
- nëse komuna i ka prej 20.000 deri 30.000 qytetarë, kuvendi i asaj komune përbëhet prej 21 anëtarëve;
- nëse komuna i ka prej 30.000 deri 50.000 qytetarë, kuvendi i asaj komune përbëhet prej 27 anëtarëve;
- nëse komuna i ka prej 50.001 deri 70.000 qytetarë, kuvendi i asaj komune përbëhet prej 31 anëtarëve;
- nëse komuna i ka prej 70.001 deri 100.000 qytetarë, kuvendi i asaj komune përbëhet prej 35 anëtarëve;
- nëse komuna i ka më shumë se 100.000 qytetarë, kuvendi i asaj komune përbëhet prej 41 anëtarëve; dhe, së fundi,
- **kuvendi i komunës së Prishtinës** përbëhet prej 51 anëtarëve.

Duke iu referuar përcaktimit te mësipërm, mbi numrin e anëtarëve te kuvendeve komunale, shihet qartë se i njëjti bazohet ne numrin e qytetarëve brenda territorit të komunës përkatëse. Kjo nënkupton që një kuvend komunal mund të ketë **minimalisht** pesëmbëdhjete (15) anëtarë dhe **maksimalisht** pesëdhjetenjë (51) anëtarë. Numrin prej 51 anëtarëve, siç shihet, e ka vetëm kuvendi komunal i kryeqytetit te Republikës së Kosovës, Prishtina.

Mandati i anëtarëve të kuvendit komunal është katër (4) vjet dhe mund të përfundoj para kohe vetëm në rrethanat e mëposhtme:

- me përfundimin e afatit 4-vjeçar;
- nëse anëtari i kuvendit ndërron vendbanimin;
- nëse anëtari i kuvendit jep dorëheqje dhe ia dorëzon kryetarit të komunës;
- nëse anëtari është dënuar me vendim te formës së prerë të gjykatës, me burgim mbi gjashtë muaj;
- nëse anëtari nuk merr pjesë në mbledhjet e kuvendit tre (3) muaj rresht pa arsye.

Anëtari i kuvendit komunal, në të njëjtën kohë nuk mund të jetë edhe deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Anëtarët e kuvendi të komunës detyrohen të marrin pjesë në mbledhjet e kuvendit të komunës, si dhe mekanizmave të tjerë komunalë, përveç nëse mungesa e tyre është e justifikueshme. Përveç këtyre çështjeve, **Ligji për Vetëqeverisjen Lokale** ka përcaktuar **përgjegjësitë kryesore** të kuvendit të komunës. Kuvendi mund të **delegojë** pushtetin e tij në komitetin e kuvendit të komunës apo te kryetari i komunës, të cilin mund ta revokojë në çdo kohë. Delegimi ka bëjë me një çështje të caktuar. Kuvendi **nuk mund të delegojë në asnjë rrethanë** përgjegjësitë për marrjen e vendimeve si në vijim:

- statutin dhe rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre, miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas statutit apo rregullores së punës;
- planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- themelimin e komisioneve të kërkuara sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale;
- zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të komunës;
- caktimin e nivelit të tarifave dhe ngarkesave;
- krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve te nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brendakomunale;
- marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës se Kosovës; dhe
- përgjegjësitë tjera që përcaktohen me ligj si të pabartshme.

Kuvendi komunal, si njëri ndër organet kryesore të komunës, përveç çështjeve të cilat u përmenden më sipër ka edhe kompetenca të tjera, të cilat janë te përcaktuara me **Ligjin për Vetëqeverisje Lokale**. Kuvendi komunal si organ kolegjial, mban mbledhje të cilat mund të jenë:

- inauguruese;
- të rregullta;
- të jashtëzakonshme; dhe
- urgjente apo solemne.

Mbledhja inauguruese është mbledhja e parë e kuvendit komunal, pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve lokale. Mbledhjen inauguruese e thërret kryetari i komunës, në ato komuna ku është zgjedhur, pesëmbëdhjetë (15) ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve. Nëse mbledhjen inauguruese nuk e thërret kryetari, brenda afatit të paraparë, atëherë atë e thërret anëtari më i vjetër i kuvendit komunal, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur mbledhjen është dashur ta thërras kryetari i zgjedhur. Nëse mbledhjen e parë inauguruese nuk e thërret as anëtari më i vjetër i kuvendit komunal, në një rast të tillë mbledhja mund të thirret nga shumica e anëtarëve te kuvendit

komunal. Ftesa për mbledhjen inauguruese të kuvendit komunal, dërgohet më së shumti shtatë (7) dite para mbledhjes, apo në raste të veçanta tri (3) ditë para mbajtjes së mbledhjes. Kryesimin e mbledhjes inauguruese e bënë anëtari me i vjeter i kuvendit komunal. Në **rend të ditës së mbledhjes inauguruese te kuvendit komunal** është vetëm **dhënia e betimit** të anëtarëve të kuvendit. Betimi është një akt solemn i cili nënshkruhet nga ana e secilit anëtar të kuvendit. Siç e kemi theksuar edhe më lartë, mosnënshtrimi i deklaratës se betimit nga ana e anëtarëve te kuvendit, në një afat të caktuar, nënkupton edhe humbjen e mandatit të anëtarit të kuvendit komunal.

Sa i përket **mbledhjeve të rregullta të kuvendit të komunës**, në një vit mbahen të paktën dhjetë seanca. Njoftimi për mbledhjet e rregullta të kuvendit të komunës, behet të paktën shtatë (7) ditë përpara dhe u dërgohet të gjithë anëtarëve. Në njoftim caktohet rendi i ditës dhe materialet për mbledhje, vendi dhe koha e mbajtjes së mbledhjes etj. Mbledhjen e rregullt te kuvendit te komunës e thërret dhe e udhëheq kryesuesi, kurse në mungesë të tij anëtari më i vjetër. **Mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit të komunës** mund të caktohen me kërkesën e së paku një të tretës (1/3) të anëtarëve te kuvendit ose kryetarit të komunës. Palët që thërrasin takimin e jashtëzakonshëm, iu jep atyre të drejtë ligjore që të caktojnë edhe rendin e ditës, i cili, në mbledhjet e jashtëzakonshme të kuvendit të komunës, nuk mund të plotësohet dhe as të ndryshohet. Kryesuesi i kuvendit të komunës është i obliguar që të theras mbledhjen e jashtëzakonshme, pas kërkesës së parashtruar. Mbledhja nuk mbahet, nëse anëtarët e kuvendit, **ministria përgjegjëse për vetëqeverisje lokale** si dhe publiku nuk janë njoftuar se paku tri (3) ditë përpara mbajtjes së saj.

Mbledhjet urgjente të kuvendit të komunës përfaqësojnë një kategori tjetër, jo të zakonshme, të takimeve të kuvendit komunal. Mbledhjet urgjete mund të thirren nga kryetari i komunës ose kryesuesi i kuvendit komunal, në rast të ndonjë fatkeqësie natyrore. **Mbledhja solemne** thirret nga kryetari apo kryesuesi i kuvendit të komunës, në rast të festave zyrtare dhe shteterore si dhe solemniteteve të tjera. Mbledhja solemne thirret se paku një (1) ditë, para mbajtjes së saj.

Në **mbledhjet e rregullta** të kuvendit të komunës, rendi i ditës caktohet nga kryesuesi, në bashkëpunim me kryetarin e komunës. Një anëtar i kuvendit komunal mund të propozojë një pikë të rendit të ditës, me kusht që çështja për të cilën propozohet në rend të ditës, të jetë çështje urgjente dhe me interes publik. Mbledhjet e kuvendit të komunës janë të hapura për publikun. Njoftimi për publikun bëhet i ditur shtatë (7) dite përpara mbledhjeve të rregullta si dhe tri (3) ditë përpara mbledhjeve të jashtëzakonshme. Një parim i tillë, përkitazi me mbledhjet e hapura vlen edhe për komisionet në kuadër të komunës përkatëse. Kuvendi i komunës, mund të vendos për **përjashtimin e publikut**, nga takimi apo vetëm një pjese e tij në rastet si në vijim:

- nëse mendohet se mbajtja e një takimi të hapur mund të shpie deri te një çrregullim publik apo dhunë;
- nëse takimi i hapur kërcënon të zbulojë informacione [dhe dokumente], te cilat janë të klasifikuara si të besueshme sipas Ligjit mbi qasjen në dokumentet zyrtare;
- nëse takimi kërcënon të zbulojë informacione të ndjeshme personale apo komerciale ose informacione lidhur me procedurat gjyqësore të tanishme apo të ardhshme.

Kuorumi për mbajtjen e secilës mbledhje të kuvendit të komunës është së paku gjysma e të gjithë anëtarëve të kuvendit. Para se të merren vendime dhe të mbahet mbledhje, gjithnjë duhet të verifikohet kuorumi i kuvendit të komunës. Kuvendi i komunës, për kryesimin dhe udhëheqjen e mbledhjeve, siç u përmend më sipër, zgjedh kryesuesin e tij, i cili nuk përfaqëson **një organ të veçantë të komunës**, sepse i tillë është vetëm kuvendi. Votimi për zgjedhjen e **kryesuesit të kuvendit komunal** është me vota të fshehta dhe zgjidhet nga radhët e anëtarëve të kuvendit, me të njëjtin mandat sikurse anëtarët e tij. Për t'u zgjedhur në raundin e parë, kandidati për kryesues të kuvendit komunal duhet të marrë më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit. Në rast se asnjëri nga kandidatet

nuk merr shumicën e mjaftueshme të votave në raundin e parë, në raundin e dytë kalojnë vetëm dy (2) kandidatët më të suksesshëm. Kryesues i kuvendit, në çdo rrethanë zgjidhet edhe në raundin e dytë kandidati i cili fiton më shumë se gjysmën e votave te anëtarëve të kuvendit.

Të drejtën e propozimit të **kryesuesit te kuvendit komunal** e ka secili subjekt politik, nismë qytetare apo kandidat i pavarur, i përfaqësuar në kuvendin komunal. Në kuadër të procedurës së votimit për zgjedhjen e kryesuesit, me qëllim të zbatimit të procedurës, krijohet komisioni për mbarëvajtjen e procesit të votimit.
Kuvendi i komunës mund të **shpërndahet** nëse nuk i kryen detyrat e përcaktuara me ligj dhe nëse në vazhdimësi bëhet jofunksional, duke rrezikuar ushtrimin e të drejtave themelore. Kuvendi i Komunës mund të shpërndahet edhe në rastet si në vijim:

- nëse nuk e zgjedh kryesuesin 30 ditë pas themelimit;
- nëse nuk e miraton statutin 60 ditë nga themelimi;
- nëse dështon ta miratojë buxhetin sipas afatit të paraparë; dhe
- nëse nuk mban mbledhje në periudhe më të gjatë se 6 muaj.

Ne rast se plotësohen kushtet ligjore të lartpërmendura, **ministria përgjegjëse për vetëqeverisje lokale** njofton qeverinë për mosfunksionimin e kuvendit të komunës. Qeveria vendos për shpërndarjen e kuvendit komunal. Me rastin e shpërndarjes se kuvendit komunal mbahen zgjedhjet e parakohshme. Në kuadër të kuvendit komunal funksionojnë edhe trupat ndihmës, të ashtuquajturat **komitete**. Ekzistojnë komitetet që janë të **përhershme** dhe ato **ad hoc**, të cilat themelohen sipas rastit. Si komitete te përhershme janë: **Komiteti për Politike dhe Financa** si dhe **Komiteti per Komunitete**. Në komunat ku së paku 10% e qytetarëve i takojnë komuniteteve joshumicë, **posti i zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete** rezervohet për përfaqësuesin e këtyre komuniteteve. Postin e zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete e mban kandidati përfaqësues i popullatës joshumicë, që ka marrë më shumë vota në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje në kuvendin e komunës.

Kryetari i komunës është udhëheqës i ekzekutivit në komunë dhe zgjidhet në zgjedhje të drejtpërdrejta, me mandat katër (4) vjecar, nga votuesit të cilët janë të regjistruar për të votuar në komunën ku mbahen zgjedhjet për kryetar të komunës. Kandidati për kryetar zgjidhet kryetar i komunës nëse fiton **më shume se 50% të numrit të përgjithshëm të votave** të vlefshme të hedhura. Nëse asnjëri nga kandidatet nuk fiton **me shume se 50% të votave të numrit të përgjithshëm të votave** të vlefshme të hedhura, **KQZ-ja** organizon raundin e dytë të zgjedhjeve në mes të dy kandidatëve, të cilët kanë fituar më së shumti vota të vlefshme. Raundi i dytë i zgjedhjeve mbahet ditën e diel, katër (4) javë pas raundit të parë. Konsiderohet që ka fituar në raundin e dytë, kandidati/ja që ka fituar numrin më të madh të votave. **Ligji për Vetëqeverisjen Lokale** nuk e kufizon rizgjedhjen e kryetarit të komunës për mandate të tjera.

Mandati i kryetarit të komunës mund të përfundojë para kohës, vetëm në rastet e mëposhtme:

- nëse vdes;
- nëse jep dorëheqje;
- nëse ndërron vendbanimin në komunë tjetër;
- nëse nuk paraqitet në punë për më shumë se 1 muaj pa arsye;
- nëse shkarkohet nga detyra në pajtim me këtë ligj;
- në rast të vendimit përfundimtar të gjyqit që e privon kryetarin e komunës nga zotësia e veprimit; dhe
- në rast të dënimit për vepër penale me një urdhër për burgim për gjashtë (6) muaj ose më tepër.

Në të gjitha rastet e tjera, përveç këtyre të përmendura më sipër, mandati i kryetarit të komunës përfundon pas kalimit të periudhës katër (4) vjeçare. Në rast se mandati i kryetarit te komunës përfundon me vdekjen e tij/saj, nënkryetari i komunës brenda tre (3) ditësh e njofton **ministrinë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale** për përfundimin e mandatit, sipas kësaj rrethane. Në rast se mandati i kryetarit përfundon me dorëheqje, atëherë nënkryetari i komunës brenda shtatë (7) ditëve e njofton **ministrinë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale**. Në rast se kryetari i komunës e përfundon mandatin pas ndërrimit të vendbanimit, atëherë po ashtu brenda shtate (7) ditëve, nënkryetari i komunës e njofton **ministrinë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale** lidhur me këtë rrethanë. Nëse kryetarit të komunës i përfundon mandati mbi bazën e vendimit gjyqësor për humbjen e zotësisë së veprimit, rrethanë kjo që përcaktohet me ligj, atëherë për këtë rrethanë nënkryetari i komunës në afat brenda dhjetë (10) ditëve e njofton **ministrinë përgjegjëse për qeverisje lokale**.

Kjo procedurë zbatohet edhe në rastin e dënimit të kryetarit të komunës për vepër penale të dënueshme prej gjashtë (6) muajsh ose më tepër. Për këtë vendim, ministrinë përgjegjëse për qeverisje lokale e njofton nënkryetari i komunës, në afat prej dhjetë (10) ditësh, nga koha kur njoftohen për vendimin e plotfuqishëm gjyqësor përmes të cilit shqiptohet dënimi. **Ligji për Vetëqeverisjen Lokale** e përcakton si rrethanë të përfundimit të mandatit të kryetarit të komunës edhe rastin kur i njëjti mungon në punë pa arsye, për më shume se një (1) muaj. Legjislacioni sekondar në fushën e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, megjithatë, nuk parasheh ndonjë mekanizëm se si mund të verifikohet rrethana, kur kryetari mungon në punë për më shume se një (1) muaj dhe se si mund të vërtetohet kjo rrethanë saktësisht, e cila mund të ndodh eventualisht tek ndonjë kryetar i komunës. Nëse ndodh të përmbushet ndonjëra nga rrethanat ligjore të përfundimit të mandatit të kryetarit të komunës, pasi **ministria përgjegjëse për qeverisjen lokale** të jetë informuar ppr ekzistimin e ndonjërësë nga rrethanat e humbjes së mandatit të kryetarit të komunës, atëherë e njëjta njofton institucionet qendrore, respektivisht presidentin dhe kryeministrin e Republikës se Kosovës si dhe kryeshefin ekzekutiv të **KQZ**-së, njoftim që bëhet në afat prej tre (3) ditësh. Në rast se ministria në fjalë nuk është njoftuar për ndonjërën nga rrethanat ligjore, sipas të cilave kryetari i komunës e përfundon mandatin, e njëjta në afat prej tridhjetë (30) ditësh ndërmerr veprime për të vërtetuar këto rrethana dhe për të siguruar informacion zyrtar për presidentin dhe kryeministrin e Republikës dhe kryeshefin e KQZ-së. Në rast të përfundimit te mandatit te kryetarit të komunës, detyrën e tij e ushtron nënkryetari i komunës, jo **zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës**, deri në zgjedhjen e kryetarit te ri te komunës. Mandati i kryetarit te porsazgjedhur përfundon në datën e njëjtë, sikurse mandati i kryetarit qe është zëvendësuar sipas ligjit. Kryetari i Komunës e bën betimin para anëtarëve te kuvendit komunal. Nëse kryetari i komunës dështon të jep betimin, brenda afatit prej një (1) muaji, pas certifikimit te rezultateve, i njëjti e humbet mandatin.

Ligjin për Vetëqeverisje Lokale i ka përcaktuar në mënyrë taksative **kompetencat e kryetarit të komunës**, të cilat janë:

- përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj;
- udhëheq ekzekutivin e komunës dhe administratën e saj dhe mbikëqyre administrimin financiar të komunës;
- shtron të gjitha kompetencat, te cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite kuvendit të komunës apo komiteteve te tij;
- ekzekuton aktet e kuvendit të komunës;
- emëron apo shkarkon zëvendësit e tij/saj;
- emëron dhe shkarkon anëtaret e tij të cilët i ndihmojnë atij në kryerjen e detyrave;
- organizon punën dhe drejton politikën e komunës;
- propozon rregullore apo akte te tjera per miratim ne kuvendin e komunës;
- propozon zhvillimin komunal, planet rregullative dhe investuese, propozon buxhetin vjetor për miratim ne kuvendin e komunës dhe e ekzekuton buxhetin e miratuar;
- raporton para kuvendit të komunës për situaten ekonomiko-financiare të komunës dhe për

zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku një herë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës; dhe
- mund të kërkojë që kuvendi i komunës ta shqyrtoje një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsideron se akti cenon legjislacionin ne zbatim dhe/apo interesin e komuniteteve.
- konsulton **nënkryetarin për komunitete** për çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin joshumicë; dhe
- kryen edhe aktivitetet të tjera që i caktohen me statut.

Varësisht nga specifikat e komunës, kryetari i komunës mund të ketë kompetenca të caktuara edhe me statut, mirëpo në asnjë mënyrë ato kompetenca që përcaktohen me statut të një komune përkatëse nuk mund të tejkalojnë, zgjerojnë apo në çfarëdo mënyre të shtojnë kompetencat e përcaktuara me ligj. Në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive ligjore, kryetari i komunës duhet të jetë i kujdesshëm që të shmang të gjitha rrethanat e konfliktit të interesit, që mund të paraqiten në praktikë, si në raport me të apo me anëtarët e familjes së ngushtë të saj/tij. Për më tepër, kryetari i komunës duhet të paraqes çdo rrethanë të konfliktit të interesit gjatë kryerjes se detyrave te tij/saj. Statuti i komunës parasheh edhe masat që duhet ndërmerren, në mënyrë që kryetari i komunës të përjashtohet nga procedurat vendimmarrëse ku mund të paraqitet konflikti i interesit.

Përpos kryetarit të komunës, një tjetër organ i cili e ndihmon kryetarin është **nënkryetari i komunës** përkatëse. Secila komunë në Republikën e Kosovës ka **vetëm një nënkryetar**. Nënkryetari emërohet nga kryetari si dhe shkarkohet nga ai. Posti i nënkryetarit shërben për të zëvendësuar kryetarin e komunës, ne rast mungese apo për të ndihmuar atë në kryerjen e punëve ekzekutive qe i takojnë me ligj. Rrethanat e përjashtimit te **konfliktit të interesit**, njëjtë sikurse tek kryetari, zbatohen edhe në rastin e **nënkryetarit të komunës**. Mandati i nënkryetarit është i njëjtë sikur ai i kryetarit. Përveç nënkryetarit si post i rregullt, në komunat ku të paktën 10% të banoreve i përkasin komuniteteve joshumicë, komunës përkatëse i takon edhe **nënkryetari për komunitete**. Nënkryetari për komunitete, emërohet me mandat të njëjtë sikur kryetari i komunës. Nënkryetari për komunitete propozohet nga ana e kryetarit të komunës dhe i njëjti duhet të miratohet nga shumica e anëtarëve të kuvendit të komunës, përshirë edhe shumicën e anëtarëve të kuvendit, nga radhët e komuniteteve joshumicë. Nënkryetari për komunitete i jep këshilla dhe udhëzime kryetarit te komunës, përkitazi me komunitetet joshumicë.

Kryetari si udhëheqës i parë ekzekutiv i komunës përkatëse, përveç autorizimeve të tij ligjore të cilat i kryen personalisht, orientimin e tij/saj strategjik në kuptimin e qeverisjes komunale e realizon përmes **drejtorive komunale**, të cilat dallojnë nga komuna në komunë dhe rregullohen me statutin e komunës. Ato janë pjesë e administratës komunale dhe udhëhiqen nga drejtoret përkatës, të cilët i emëron dhe i shkarkon kryetari i komunës. Eprorët e drejtorive, drejtorët, i raportojnë vazhdimisht **kryetarit te komunës** për punën e tyre dhe për procesin e vendimmarrjes së tyre.

Standardet e shmangies së konfliktit të interesit, njëjtë sikur për kryetarin dhe nënkryetaret vlejnë edhe për udhëheqësit e drejtorive komunale. Kryetari, nënkryetaret, drejtoritë, kryesuesit, zëvendëskryesuesit dhe të gjithë anëtarët e kuvendit komunal nuk konsiderohen pjesë e shërbimit civil komunal. Të gjithë personat e tjerë të punësuar që paguhen nga buxheti i Republikës së Kosovës, në kuadër të komunës përkatëse, vlerësohen si pjesë e shërbimit civil komunal. Statusi i shërbyesve civilë komunalë nuk varet nga proceset zgjedhore në komunat përkatëse. Administrata komunale udhëhiqet nga **udhëheqësi i personelit të administratës** i cili rekrutohet dhe largohet nga pozita, sipas procedurave, nga ana e kryetarit te komunës.

Kryetari i komunës, për kryerjen e detyrave te tij/saj është përgjegjës vetëm ndaj kërkesave që përcaktohen me KKos dhe ligj. Një logjikë e tillë e përgjegjësie mund të vërehet tek mënyra se si e rregullon **Ligji për Vetëqeverisjen Lokale** çështjen suspendimit dhe të shkarkimit të kryetarit të komunës. **Kryetari i komunës** mund të **suspendohet** me vendim të qeverise, nëse i njëjti ka cenuar kushtetutën dhe ligjet

në fuqi. Suspendimi i tij/saj behet në afat prej tridhjetë (30) ditëve, në rast të paraqitjes së rrethanës për suspendim (cenimit të kushtetutës apo ligjit).270 Rekomandimin për suspendim të kryetarit të komunës, e bënë **ministria përkatëse për qeverisje lokale.** Qeveria, **me rastin e suspendimit të kryetarit të komunës**, lëndën ia dërgon edhe GJKRKS, e cila, nëse përkrahë vendimin e qeverisë për suspendim, jep dritën jeshile për shkarkim përfundimtar të kryetarit të komunës nga ekzekutivi kosovar. Legjislacioni sekondar në fushën e vetëqeverisjes lokale nuk përcakton detaje dhe çështje të tjera që kane të bëjnë me procedurën e **suspendimit** dhe të **shkarkimit** të kryetarit të komunës. Po ashtu, legjislacioni në fuqi nuk jep detaje se në çfarë mënyre, procedure ose çfarë afati GJKRKS duhet të jep vendim lidhur me vendimin e qeverise për suspendim të kryetarit të komunës. Një kompetencë e tillë nuk përcaktohet në nenin 113 të **KKos**. Dispozita e vetme kushtetuese, ajo e nenit 113.10 të KKos, që përcakton se juridiksioni shtesë mund të caktohet me ligj, nuk thotë asgjë sa i përket procedurës dhe afatit të vendosjes lidhur me vendimin e qeverisë për suspendim.

Përveç **organeve komunale** të përmendura më sipër, **legjislacioni sekondar** në fushën e qeverisjes lokale në Republikën e Kosovës përcakton edhe themelimin e **keshillave lokale**, si organe të cilat bashkëpunojnë me komunën. Këshillat nënkuptojnë trupa të zgjedhur që përfaqësojnë në mënyrë të organizuar komunitetin e një apo më shumë fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve të caktuara. Komunat që kanë deri në 10.000 banorë duhet të kenë deri në katër (4) këshilla lokale, kurse ato që kanë deri në 20.000 banorë, tetë (8) këshilla lokale. Komunat që kanë mbi 100.000 banorë duhet të kenë deri në dyzet (40) këshilla lokale. Kryeqyteti duhet t'i ketë deri në pesëdhjetë (50) këshilla lokale. Këshillat lokale mund të kenë 5 deri ne 9 anëtarë dhe duhet të përfaqësojnë interesat e fshatit, lagjes apo vendbanimit përkatës. Mandati i rregullt i këshillave lokale është katër (4) vite. Themelimi i këshillave lokale, ndërkaq, bëhet nga një **komision** i cili është në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve. Prej kësaj përbërje, katër (4) anëtare janë nga kuvendi i komunës; një (1) anëtar nga ekzekutivi; një (1) përfaqësues nga fshati dhe një (1) përfaqësues nga shoqëria civile. Mandati i këtij **komisioni** është i lidhur me kuvendin e komunës.

Bashkëpunimi i komunës me këshillat lokale bëhet në fushat e caktuara, të cilat janë kompetencë e komunave. Këto fusha mund të jenë si në vijim:

- planifikimi urban dhe rural;
- furnizimi me ujë dhe rregullimi i kanalizimit;
- shëndetësia publike;
- mbrojtja lokale e ambientit;
- turizmi;
- hapësirat publike dhe varrezat; dhe
- aktivitetet kulturore dhe sportive.

Në kuadër të bashkëpunimit në mes të komunës dhe këshillave lokale, mund të lidhet edhe **marrëveshje bashkëpunimi**. Kryetari i komunës, në bashkëpunim me kryesuesin e kuvendit komunal, organizojnë të paktën dy (2) takime në vit me **kryetaret e këshillave lokale**. Për punën dhe angazhimin e tyre në kuadër të udhëheqjes së këshillave lokale, kryetaret e këtyre këshillave kompensohen nga buxheti i komunës, në shumën ekuivalente me kryetaret e komiteteve obligative komunale.

Nga organet komunale dhe kompetencat e tyre, duhen dalluar **kompetencat komunale, të cilat** gjithnjë ushtrohen në bazë të **parimit të subsidiaritetit**. Ky parim nënkupton që çështjet publike realizohen, sa më shumë që të jetë e mundur, në interes të qytetarëve nga niveli më i ulet i qeverisë që është në gjendje të ofrojë shërbime efikase. Në këtë kontekst, **Ligji për Vetëqeverisjen Lokale** përcakton tri (3) kategori të kompetencave të cilat i ushtrojnë komunat kosovare. Ato janë për sa vijon:

- **kompetencat vetjake të komunave;**
- **kompetencat e deleguara të komunave**; dhe
- **kompetencat e zgjeruara të komunave.**

Kompetencat vetjake janë **kompetenca të plota ekzekutive**, të cilat i kane komunat me qëllim të përfaqësimit të interesit lokal. Komunat kanë kompetenca vetjake në fushat si në vijim:

- zhvillimin lokal ekonomik;
- planifikimin urban dhe rural;
- shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;
- zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;
- mbrojtjen e mjedisit lokal;
- ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujerave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehjes lokale;
- përgjigjen ndaj rasteve emergjente lokale;
- ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit;
- promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor;
- ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesa për të cenueshmit, strehimin familjar, përkujdesin fëmijëror, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionisteve të mirëqenies sociale;
- shëndetësinë publike;
- licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitetet kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë;
- emërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike;
- turizmit;
- aktivitetet kulturore dhe të lira;
- çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre, apo që nuk i është përcaktuar një autoriteti tjetër.

Ushtrimi **kompetencave vetjake** komunale bëhet nga organet e komunës përkatëse (kuvendi komunës, kryetari komunës, nënkryetarët dhe organet e tjera), në bazë të statutit të komunës, por edhe akteve të tjera nënligjore, përfshirë edhe vendimet që i nxjerrin këto organe. Sikundër u pa më sipër, aktet juridike të cilat nxirren nga organet komunale dhe të cilat zbatohen në territorin e një komune, me qellim të ushtrimit të kompetencave komunale, përveç statutit, janë: rregulloret, vendimet, marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet komunave dhe urdhëresat.

Kompetencat e deleguara komunale, përbëjnë kategorinë e kompetencave të cilat i delegohen komunave nga institucionet e pushtetit qendror. Si të tilla, ato gjithnjë duhet të ushtrohen në pajtim me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës. Kompetencat që mund të delegohen kanë të bëjnë me fushat vijuese:

- shënimet kadastrale;
- regjistrimin civil;

- regjistrimin e votuesve;
- regjistrimin e biznesit dhe licencimin;
- distribuimin e pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve);
- mbrojta e pyjeve që ndodhen në territorin e komunës në kuadër të autorizimeve të deleguara nga autoriteti qendror, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e drunjve në bazë të rregullave të miratuara nga qeveria.

Delegimi i kompetencave nga ana e autoriteteve qendrore në komunat përkatëse, në fushat e mësipërme, gjithnjë duhet të shoqërohet me **planifikimet financiare dhe mbështetje buxhetore për realizimin dhe ushtrimin e tyre**. Autoritetet qendrore, përveç fushave të mësipërme mund të delegojnë edhe kompetenca të tjera, në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.

Sikundër është sqaruar më sipër, në **Republikën e Kosovës**, disa komuna, ku **komuniteti serb** është shumicë, gëzojnë **kompetenca vetjake të zgjeruara** në fusha të caktuara. Ky përcaktim e ka burimin nga **Plani Ahtisari**, i cili në kuadër të procesit të decentralizimit i kishte paraparë këto kompetenca (Aneksi III, neni 4 i Planit Ahtisari). **Ligji për vetëqeverisjen lokale**, për komunat përkatëse, kompetencat e zgjeruara vetjake i kategorizon në disa fusha. Ato fusha janë për sa vijon:

- përkujdesi dytësor shëndetësor;
- shkollimi universitar;
- fusha e kulturës dhe zgjedhja e komandantëve të stacioneve policore lokale

Autoritetet qendrore në Republikën e Kosovës monitorojnë ushtrimin e **kompetencave të zgjeruara** në pajtim me legjislacionin qendror, që parasheh qasje të barabartë në shërbimet publike; standarde minimale sasiore dhe cilësore në ofrimin e shërbimeve publike; kualifikime minimale të personelit dhe trajnimit të tyre, parimet e përgjithshme për licencim dhe akreditim të ofruesve të shërbimeve publike. Komunat që ushtrojnë kompetenca të zgjeruara komunale mund të bashkëpunojnë me çdo komunë në ofrimin e shërbimeve të tilla. Komuna e **Mitrovicës së Veriut**, **Graçanicës** dhe **Shtërpcës** kanë kompetenca për ofrimin e përkujdesit dytësor shëndetësor, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve të përkujdesit shëndetësor, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e personelit dhe administratorëve të përkujdesit shëndetësor. Komuna e **Mitrovicës së Veriut** ka kompetencë për shkollim të lartë, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve shkollore, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve arsimor. Të gjitha komunat, **në të cilat komuniteti serb është shumicë**, kanë kompetenca për të ushtruar përgjegjësitë për çështjet kulturore, duke përfshirë mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe religjioze serbe dhe të tjerëve, brenda territorit komunal, si dhe për mbështetjen e komunitetve lokale religjioze, në pajtim me ligjin në zbatim. Komunat mund të **bashkëpunojnë** me çdo komunë tjetër në çështjet kulturore.

Siç u tha edhe më sipër, me qëllim të ushtrimit të kompetencave të tyre organet e komunës nxjerrin akte nënligjore. Organi kryesor i cili nxjerr shumicën e akteve komunale është kuvendi i komunës, i cili nxjerr aktet si në vijim:

- statutin;
- rregulloret e komunës;
- vendimet për ushtrimin e kompetencave te caktuara;
- marrëveshjet e bashkëpunimit;
- aktet e tjera që parashihen sipas ligjeve në fuqi.

Në anën tjetër, **kryetari i komunës** nxjerr **urdhëresa**, përmes të cilave ushtron kompetencat dhe autorizimet e tij. Akti juridik që normon këtë aktivitet normativ në nivel komune është **Ligji për Vetëqeveris-**

jen Lokale. Me qëllim të **hartimit të akteve normative te komunave**, organi përkatës i komunës cakton zyrtarin përgjegjës, brenda drejtorisë apo fushës përkatëse i/e cili do të përgatitë draftin fillestar të propozuar. Hartimi i akteve normative të komunës gjithnjë bëhet në pajtim me dispozitat e **Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale**. Zyrtari përgjegjës, i caktuar për **hartimin e draftit fillestar** të aktit normativ këtë e bënë në bashkëpunim me zyrën ligjore të komunës duke respektuar të gjitha procedurat e nevojshme për hartimin e akteve normative që përcaktohen me akte nënligjore të komunës. Teksti i akteve normative i përmbahet standardeve të caktuara të hartimit të një akti normativ, të cilat janë të zbatueshme në Republikën e Kosovës. Kjo vlen, si për nga struktura ashtu edhe forma që duhet të ketë akti normativ i komunës. Të drejtë për të propozuar hartimin e akteve të komunës kanë: kryetari i komunës; kryesuesi i kuvendit komunal; komitetet e kuvendit të komunës; anëtarët e kuvendit komunal dhe 15% e qytetarëve të komunës përkatëse me të drejtë vote.

Procesi i hartimit të akteve normative, deri tek hyrja në fuqi kalon nëpër disa hapa procedural, të cilët janë:

- hartimi i aktit fillestar;
- konsultimi i brendshëm i autoriteteve lokale;
- vlerësimi i ndikimit financiar të aktit të propozuar;
- plotësimi i projekt aktit pas përfundimit te konsultimeve;
- konsultimi publik;
- finalizimi i projekt aktit pas marrjes se komenteve nga konsultimi publik;
- miratimi i aktit në kuvendin e komunës;
- nënshkrimi i aktit normativ te komunës;
- dërgimi i aktit të komunës për konfirmim të ligjshmërisë nga ministria përkatëse për qeverisje lokale.

Pas përfundimit të të gjitha procedurave dhe miratimit te aktit ne kuvendin e komunës, akti normativ i miratuar nënshkruhet nga kryesuesi i kuvendit komunal dhe i njëjti publikohet. Nënshkrimi i aktit të miratuar bëhet në tri (3) kopje origjinale. Versioni që publikohet duhet të përputhet në tërësi me versionin e miratuar të aktit. Akti i nënshkruar i komunës publikohet në ueb faqen e komunës, vetëm pasi **ministria përkatëse për vetëqeverisje lokale** të ketë dhënë përgjigje për **ligjshmërinë** e aktit te propozuar te komunës, brenda aftit 15 ditor, siç përcaktohet me Ligjin për vetëqeverisjen lokale. Në rast se **ministria përkatëse për vetëqeverisje lokale** nuk i jep përgjigje komunës përkatëse brenda këtij afati, atëherë komuna e shpall aktin ne ueb faqe edhe pa marrë përgjigjen në fjalë. Aktet komunale publikohen në ueb faqen e komunës ne gjuhët zyrtare te komunës. Pas publikimit në ueb faqe, aktet komunale po ashtu publikohen edhe në **Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës**. Aktet e komunës **hyjnë në fuqi** shtatë (7) ditë pas shpalljes në ueb faqen e komunës, përveç nëse me vetë aktin përkatës nuk është përcaktuar ndryshe. Mbikëqyrja e zbatimit të akteve komunale bëhet nga **ministria përkatëse për vetëqeverisje lokale.**

Një çështje tjetër shumë më rëndësi në qeverisjen lokale kosovar, dhe në qeverisjen lokale në krejt vendet e rajonit përreth Kosovës, ka të bëj me **financimin e komunave** dhe **autonominë (mëvetësinë) e tyre financiare**. Financat komunale bazohen ne krijimin e mundësive financiare për ushtrimin e kompetencave të komunës përkatëse, duke marre parasysh specifikat që ka ajo. Sipas **Ligjit për vetëqeverisjen lokale**, buxheti i komunës përbëhet nga të **hyrat vetjake të komunave**; **grantet** nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe të **hyrat e tjera**. Buxheti dhe financat komunale rregullohen me **Ligjin për financat e pushtetit lokal**. Aty ku shërbimet komunale ofrohen nga ndërmarrjet komunale, ato ndërmarrje duhet t'ia dorëzojnë buxhetet e tyre kuvendit të komunës për miratim. Propozimet buxhetore duhet të përfshijnë strukturën e propozuar të tarifës për ofrimin e shërbimeve dhe duhet të dorëzohen para datës 15 nëntor të vitit të ardhshëm fiskal. Kur një ndërmarrje ofron shërbime publike komunale për më shumë se një komunë, komunat themelojnë bord të përbashkët menaxhues për mbikëqyrje

të aktiviteteve të ndërmarrjes.

Burimet financiare të komunave dhe buxheti i tyre duhet të jetë i barasvlershëm me kompetencat e tyre, te cilat përcaktohen me **Ligjin për Vetëqeverisje Lokale**. Kufizimet në pavarësinë financiare te komunave janë të bazuara edhe në parimin se **komuna**, brenda territorit të saj përveç tatimit në pronë, **nuk mund të caktojë apo vjelë çfarëdo detyrimi apo takse tjetër**, siç janë:

- detyrimet doganore;
- detyrimet tjera;
- tatimin në të ardhurat personale;
- tatimin në vlerën e shtuar;
- akcizën;
- tatimin në kapital etj.

Nga ky rregull ekziston një përjashtim, megjithatë, në rastet kur një kompetencë e tillë i delegohet komunës përkatëse, në mënyrë formale nga ana e Qeverisë së Republikës se Kosovës. Kjo përcaktohet qartë me **Ligjin për financat e pushtetit lokal**. Siç u tha edhe më sipër, është parim themelor që burimet e financimit të komunës të bazohen në ushtrimin e kompetencave vetjake, të deleguara apo kompetencave të zgjeruara. Qeveria duhet të kujdeset që komunave të caktuara t'iu ofrojë fonde të mjaftueshme për ushtrimin e kompetencave vetjake, por edhe kompetencave te deleguara, duke u siguruar qe burimet financiare janë të mjaftueshme, për mbulimin e shpenzimeve të arsyeshme për ushtrimin e kompetencave vetjake apo të deleguara. Një parim i tillë vlen po ashtu edhe për ushtrimin e kompetencave të zgjeruara komunale, te cilët sipas **Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale** u janë dhënë komunave me shumicë serbe. **Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal** i ka përcaktuar burimet financiare komunale dhe llojet e tyre, të cilat paraqiten për sa vijon:

- të hyrat vetjake të komunave;
- grantet operative;
- grantet per kompetencat e shtuara;
- transferet për kompetencat e deleguara;
- grantet e jashtëzakonshme;
- të hyrat nga ndihma financiare nga Republika e Serbisë;
- të hyrat nga huadhëniet e komunës.

Të **hyrat vetjake te komunave** përfshijnë kategoritë si në vijim:

- taksat komunale, gjobat, tarifat e shfrytëzimit, pagesat e tjera për shërbimet publike të ofruara nga komuna si dhe detyrimet rregullatore dhe gjobat e autorizuara në bazë të ligjit;
- qiratë në pronat e paluajtshme të cilat ndodhen në komunë dhe të cilat janë nën administrimin ose në pronësi të komunës;
- të hyrat nga shitja e pasurive komunale;
- të hyrat nga ndërmarrjet të cilat janë plotësisht ose pjesërisht në pronësi të komunës;
- bashkëpagesat nga konsumatorët e shërbimeve arsimore dhe shëndetësore të cilat ofrohen nga komuna;
- të hyrat e realizuara nga cilado agjenci, departament ose organizatë e komunës si rezultat i ofrimit të çfarëdo malli ose shërbimi;
- interesi në depozitat komunale, nëse ekziston;
- grantet dhe/ose donacionet nga qeveritë e huaja (përveç ndihmës financiare nga **Republika e Serbisë**) ose nga organizatat e jashtme, duke përfshirë organizatat qeveritare dhe joqeveritare si dhe institucionet ndërkombëtare dhe multinacionale;
- të gjitha kategoritë e tjera të të hyrave të cilat janë përcaktuar si të hyra vetjake komunale në

bazë të një ligji të Republikës së Kosovës.

Ligji për Financat e Pushtetit Lokal, ka përcaktuar **disa lloje të taksave**, të cilat i mbledh komuna përkatëse me qëllim të krijimit të të hyrave vetjake. Taksat dhe të hyrat e tjera përmes të cilave komuna krijon të **hyra vetjake** janë:

- taksa për lejen në ushtrimin e veprimtarisë afariste (përmes kësaj takse komunat mund të kërkojnë nga bizneset, të cilat tashmë janë të regjistruara në regjistrin e bizneseve të Kosovës, që të marrin leje për ushtrimin e veprimtarisë së tyre, të cilat janë brenda territorit të komunës; kjo taksë quhet "leja për ushtrimin e veprimtarisë afariste"; **Ligjit për financat e pushtetit lokal** përcakton detaje të tjera përkitazi me këtë lloj të taksës, si kategori e të hyrave vetjake të komunës);
- taksa për lejen e shërbimeve profesionale (përmes kësaj takse, komuna mund të kërkojë nga shoqëritë tregtare qe janë tashmë të regjistruara, që të marrin leje në komunë për ofrimin e shërbimeve profesionale; taksa për këto shërbime caktohet nga komuna me rregullore të veçantë);
- taksa për automjetet motorike;
- taksat administrative komunale;
- taksat për leje të ndërtimit;
- taksat e tjera komunale (taksa për parkimin e automjeteve ne prone komunale;
- taksa për shfrytëzimin e pronës komunale per rekreacion;
- taksa për gjueti;
- taksa për marketing ose ekspozita tjera në pronën komunale;
- taksa për ceremonitë e ndryshme p.sh. kurorëzime;
- taksa komunale të tjera sipas nevojës;
- taksa për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare;
- tarifat rregullative për zhvillimin dhe ruajtjen e infrastrukturës (ndërtimin e ndërtesave të reja ose rehabilitimin e ndërtesave ekzistuese);
- gjobat në trafik;
- gjobat në shkeljen e rregullave komunale;
- të hyrat nga qiradhënia e pronës komunale;
- tarifat për pagesat në arsim dhe shëndetësi.

Përpos të **hyrave të caktuara vetjake**, një kategori e të hyrave komunale janë edhe **grantet**, të cilat ligji i definon si **grante operative** dhe mund të jenë dy llojesh: **grantet e përgjithshme** dhe **grantet për arsim dhe shëndetësi**. Grantet e përgjithshme të komunave janë të hyra të cilat mund të shfrytëzohen për ushtrimin e kompetencave komunale në përgjithësi, kurse grantet për arsim dhe shëndetësi shërbejnë për ushtrimin e kompetencave specifike nga fushat përkatëse. Komuna ka të drejtë edhe për **grantet e jashtëzakonshme**, në rast të ndonjë fatkeqësie natyrore, kryengritje civile, luftë kundër terrorizimit etj. Granti i jashtëzakonshëm i ndahet komunës nga qeveria, për sanimin e plotë ose të pjesshëm të gjendjes së krijuar në komunë nga rrethana e paraqitur.

Qeverisja lokale nuk do të kishte kuptim pa kategorinë kushtetuese e ligjore të **bashkëpunimit ndërkomunal**, i cili nënkupton marrëdhëniet e vendosura midis dy apo më shumë komunave të Republikës së Kosovës, në bazë të marrëveshjes për ushtrimin më efikas dhe më efektiv të kompetencave dhe detyrave të tyre vetjake dhe të zgjeruara, të përcaktuara me ligj, si dhe për realizimin e interesave dhe qëllimeve të tyre të përbashkëta, në fushën e shërbimeve publike komunale dhe të zhvillimit lokal. Bashkëpunimi ndërkomunal mund të jetë: **bashkëpunim ndërkomunal vendor** dhe **bashkëpunim ndërkomunal ndërkombëtar**. Bashkëpunimi ndërkomunal ndërkombëtar nënkupton të gjitha format e bashkëpunimit të komunave të Republikës së Kosovës, me komuna ose institucione të tjera të vetëqeverisjes lokale jashtë Republikës së Kosovës, për nevojat e binjakëzimit ose formave të tjera të bashkëpunimit në

kuadër të kompetencave vetjake dhe të zgjeruara të komunave. Bashkëpunimi ndërkomunal i komunave vendore bazohet në parimet për sa vijon:

- interesin e përbashkët lokal;
- interesin e një ose më shumë komunave për të ushtruar kompetencat vetjake dhe të zgjeruara;
- vullnetin e dy ose më shumë komunave për të krijuar marrëdhënie në bashkëpunimin ndërkomunal;
- ndarjen e përgjegjësive midis komunave dhe bashkimin e resurseve komunale për nevojat e bashkëpunimit;
- përmirësimin e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve komunale në dobi të qytetareve.

Për bashkëpunimin në mes të komunave, në kuptim të realizimit të bashkëpunimit ndërkomunal **ekziston një procedurë e caktuar ligjore**. Nisma për bashkëpunimin ndërkomunal, parashtrohet me shkrim nga: kryetari i komunës përkatëse; një e treta (1/3) e anëtarëve të kuvendit të komunës; 5% e qytetarëve me të drejtë vote në komunën përkatëse; Qeveria e Republikës së Kosovës, kur bashkëpunimi ndërkomunal konsiderohet të jetë me interes të veçantë publik dhe lokal. Arsyetimi i nismës për bashkëpunimin ndërkomunal duhet të përmbajë elementet si në vijim:

- qëllimin e bashkëpunimit ndërkomunal;
- kompetencat që kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndërkomunal;
- komunat që përfshihen në bashkëpunim;
- format e bashkëpunimit;
- përfitimet e pritura;
- implikimet e mundshme financiare nga bashkëpunimi;
- çështjet e tjera me rëndësi etj.

Nisma për bashkëpunim ndërkomunal, nëse nuk është marrë nga kryetari i komunës, gjithsesi për ta jetësuar këtë nismë (nëse ajo është marrë nga një organ tjetër kompetent) duhet edhe mendimi me shkrim i kryetarit të komunës. Në çdo variant bashkëpunimi ndërkomunal duhet që të miratohet nga kuvendi komunal i komunës përkatëse që merr nismën për këtë bashkëpunim. Vendimin përfundimtar për nismën për bashkëpunim ndërkomunal e merr kuvendi komunal i komunës përkatëse, që e ka propozuar nismën. Vendimi merret në një seancë të hapur të kuvendit komunal, maksimalisht në afat prej nëntëdhjetë (90) ditësh nga dita kur është marrë nisma. Po ashtu, kuvendi komunal me vendim, autorizon kryetarin e komunës, që t'i fillojë konsultimet me të gjitha komunat që dëshirojnë të përfshihen në kuadër të bashkëpunimit ndërkomual, me qëllim të arritjes së marrëveshjes për këtë bashkëpunim. Pas marrjes së autorizimit, kryetari i komunës që inicion bashkëpunimin ndërkomunal, i njofton të gjitha komunat e tjera që do të përfshihen në këtë bashkëpunim. Komuna të cilës i dërgohet njoftimi për përfshirje në bashkëpunim ndërkomunal, nga kryetari i komunës që ka iniciuar këtë bashkëpunim, po ashtu në afat maksimal, prej nëntëdhjetë (90) ditësh e voton nismën në kuvendin e saj dhe autorizon kryetarin e komunës që ta përfaqësojë komunën në udhëheqjen e marrëveshjes për bashkëpunim ndërkomunal.

Siç u sqarua edhe më sipër, bashkëpunimi ndërkomunal bazohet në **marrëveshje ndërmjet komunave** që përfshihen në bashkëpunim. Marrëveshja duhet të përmbajë elementet si në vijim:

- palët kontraktuese;
- lëndën kryesore të marrëveshjes, qëllimin dhe afatin e saj kohor;
- të drejtat dhe detyrimet e secilës palë të përfshirë në marrëveshje;
- formën ligjore të bashkëpunimit dhe burimet e financimit dhe buxhetit;
- kushtet për tërheqje nga marrëveshja dhe shkëputjen e marrëveshjes;

- procedura e zgjidhjes së konflikteve eventuale;
- hollësitë tjera të marrëveshjes ashtu siç janë pajtuar palët/komunat partnere.

Marrëveshja për bashkëpunim ndërkomunal nënshkruhet nga kryetarët e komunave përkatëse, që marrin pjesë në bashkëpunim. Pas nënshkrimit të marrëveshjes të gjitha kuvendet e komunave që marrin pjesë në bashkëpunim ndërkomunal, duhet ta miratojnë edhe një herë marrëveshjen e bashkëpunimit. Marrëveshja për bashkëpunim ndërkomunal hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë nga ministria përkatëse e pushtetit lokal dhe shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji për bashkëpunim ndërkomunal përcakton në detaje llojet dhe përmbajtjen e **formave** të këtij bashkëpunimi, të cilat janë si në vijim:

- grupit të përbashkët të punues;
- organit të përbashkët administrativ;
- institucionit të përbashkët publik;
- ndërmarrjes së përbashkët publike;
- partneriteteve të përbashkëta publiko-private.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka obligim ligjor nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal dhe e njëjta me propozim të ministrisë përkatëse për qeverisje lokale, përmes një rregulloreje të veçantë mund të përcaktojë fushat me rëndësi dhe me interes të gjerë, për të cilat mund të ndajë mjetet për bashkëpunim ndërkomunal të komunave.

Për nevojat e bashkëpunimit, komunat mund të lidhin **marrëveshje me institucione dhe komuna jashtë Republikës së Kosovës**. Në kuadër të bashkëpunimit ndërkomunal ndërkombëtar, në asnjë rrethanë komunat nuk kanë të drejtë të heqin dorë nga kompetencat e tyre të përcaktuara me ligj, apo t'i delegojnë ato, në çfarëdo forme. Një formë e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar është edhe binjakëzimi mes komunave. Ka pasur disa praktika ku komunat e Republikës se Kosovës, janë binjakëzuar me komunat e tjera jashtë territorit të Republikës së Kosovës. Gjatë bashkëpunimit te tyre ndërkomunal, me qellim të ushtrimit të kompetencave vetjake dhe të zgjeruara, në asnjë mënyrë komunat nuk mund të ushtrojnë bashkërisht kompetencat të cilat i takojnë kuvendit komunal, të përcaktuara sipas nenit 12 të **Ligjit për vetëqeverisje lokale**. Në kuadër të bashkëpunimit ndërkomunal, komunat kanë të drejtë të bashkëpunojnë edhe me komunat dhe agjencitë qeveritare të **Republikës së Serbisë**, me qëllim të ofrimit të asistencës financiare dhe teknike.

Ligji për vetëqeverisje lokale përcakton se, me qellim të promovimit të interesit të përbashkët, komunat mund të formojnë dhe të marrin pjesë në asociacionet e komunave të cilat janë funksionale. **Republika e Kosovës** e ka asociacionin e saj të komunave, i cili është themeluar në vitin 2001, pas mbajtjes së zgjedhjeve të para lokale dhe si i tillë është i bazuar në nenin 10 të **KEVL**. Asociacioni i Komunave të Kosovës (ASK) është person juridik, me status të organizatës jo për përfitim. Misioni kryesor i tij është që të krijojë qeverisje lokale efikase, të qëndrueshme dhe demokratike, përmes përpjekjeve të përbashkëta me komunat që janë anëtare të këtij asociacioni. Dokumentet kryesore përmes të cilave rregullohet puna dhe veprimtaria e ASK-së është statuti i ASK-së dhe rregullorja e punës. **ASK-ja** ka këtë strukturë organizative:

- kuvendin me njëqind e dhjetë (110) anëtarë;
- këshillin e kryetarëve me tridhjetë e katër (34) kryetarë;
- bordi udhëheqës me shtatë (7) anëtarë;
- kolegjiumet profesionale, dymbëdhjetë (12) sosh;
- administrata, e cila aktualisht deri në këtë moment (prill 2023) ka katërmbëdhjetë (14) punëtorë.

Përveç ASK-së, në Kosovë pritet të formohet edhe **A/BKS-ja**, bazuar në **MO**, përmes së cilës përligjësohen dhe fuqizohen të gjitha tratativat e Kosovës me të cilat është marrë përsipër detyrimi i vendit për themelim të kësaj strukture parashtetërore serbe. E themi parashtetërore, sepse në bazë të një draft-statuti të propozuar nga një ekip menaxhues serb, i themeluar nga qeveria e Kosovës, ky nuk do të jetë sikur **ASK-ja**, por një bashkësi e komunave serbe me kompetenca të theksuara shtetërore, që do të veprojë jashtë rendit juridik të Kosovës dhe në paralel më këtë rend, duke shërbyer si një rival i pushtetit qendror në Kosovë dhe rendit ekzistues kushtetuese. Ky draft u paraqit para pushtetarëve të Kosovës më 2 maj 2023, të cilët, nga ana e tyre, kishin paraqitur një draft-koncept të tyrin për një lloj autonomie për vetëmenaxhim të komunitetit serb të Kosovës, një koncept shumë nebuloz dhe i paqartë për palën serbe.

Baza e parë juridike e themelimit të **A/BKS-së** gjendet në **MA 2013**, e cila në qershor të vitit 2013 u pat ratifikuar në Kuvendin e Kosovës, nëpërmjet ligjit, ashtu siç e përcakton neni 18 i KKos.[103] Dy vite pas ratifikimit të MA 2013, konkretizimi i organizimit dhe funksionimit të **A/BKS-së**, si dhe procedurat që do të ndiqeshin për themelimin e tij, u konkretizuan me MA 2015. MO, sikundër u tha, i ka dhënë përligjësimin përfundimtar këtij zotimi ndërkombëtar të Kosovës, gjithnjë me supozim që edhe Serbia vepron me mirëbesim (bona fide) në ekzekutimin e detyrimeve të saj ndërkombëtare që ka marrë në dialogun e Brukselit me Kosovën. Kjo sepse, nëse vepron me keqbesim, atëherë edhe Kosova ka të drejtën e njëjtë – moszbatimin e detyrimeve të marra ndërkombëtare në raport me Serbinë. Kjo është çështje politike dhe ngelet të shihet, ne nuk e trajtojmë tutje shkaku i natyrës së saj.

Në **MA 2015** përcaktohet themelimi i një ekipi të menaxhimit që do të hartojë projekt-statutin brenda katër muajve nga data e nënshkrimit, kurse qeveria e Kosovës miraton të njëjtin me anë të një vendimi (dekreti) qeveritar. MA 2015 ka ofruar më shumë detaje për strukturën organizative të **A/BKS-së**, për dallim nga MA 2013. Edhe pse **Republika e Kosovës** ka marrë obligim ndërkombëtar për themelimin e **A/BKS-së**, deri më 2 maj 2023 kur u dorëzua në Bruksel drafti i parë i statutit, më herët nuk kishte ndodhur përpilimi i tij dhe, për pasojë, as themelimi i **A/BKS-së**, për shkak të kundërshtimeve të shumta politike që ka pasur në **Republikën e Kosovës**, që nga nënshkrimi i MA 2015. Për shkak të kundërshtimeve politike dhe situatës së krijuar përkitazi me themelimin e **A/BKS-së**, presidentja e Republikës se Kosovës, znj. **Atifete Jahjaga**, vendosi që të kërkonte nga GJKRKS kontrollin e kushtetutshmërisë të MA 2015. Nga procesi i vlerësimit dhe i sqarimit të çështjeve kushtetuese të ngritura nga ish-presidentja Jahjaga më 2015, **GJKRKS** pat gjetur se shumë pjesë të marrëveshjes nuk ishin në përputhje me **KKos**. GJKRKS, megjithatë, ka konstatuar se **A/BKS-ja** duhet të themelohet, ndonëse me një sërë gjetjesh se MA 2015 ishte jo në pajtim me "standardet kushtetuese", term ky të cilin GJKRKS e përdor shumë shpesh në aktgjykimin e saj për këtë rast.[104] Më konkretisht, **GJKRKS** në këtë rast konstatoi që MA 2015 nuk është në tërësi me frymën e KKos, respektivisht me nenin 3 paragrafi 1, kapitullin II të KKos, që ka të bëjë me liritë dhe të drejtat themelore të njeriut si dhe kapitullin III, që ka të bëjë me të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. GJKRKS gjithashtu dha udhëzime se si duhen elaboruar dhe zbatuar parimet kushtetuese në aktin me të cilin do të themelohet **A/BKS-ja**, në mënyrë që ai të jetë në përputhje me frymën e KKos dhe nenet e saj si vijon: 3, 7, 12, 21, 44, 57, 59, 60, 61, 62, 79, 81, 93, 101, 113, 123, 124 dhe 137. Me fjalë të tjera, ky aktgjykim ka përcaktuar se, kurdo që të themelohet **A/BKS-ja** nga q**everia e Republikës se Kosovës**, duhet të merret parasysh që akti themelues dhe **statuti i A/BKS-së** të hartohen në pajtim me frymën e KKos dhe standardet kushtetuese që përmbajnë nenet e lartpërmendura. Ndër të tjera, GJKRKS, në këtë aktgjykim, duke u bazuar në MA 2015, konstaton që akti themelues i **A/BKS-së** si dhe statuti, duhet të shqyrtohen në GJKRKS sa i përket kushtetutshmërisë së tyre. Ajo që u dorëzua më 2 maj 2023 në **Bruksel**, sigurisht që as për së afërmi nuk reflekton të gjeturat e këtij aktgjykimi, sepse hapur mëton formimin e një strukture parashtetërore paralele dhe rivale kundrejt pushtetit qendror dhe rendit kushtetues në Kosovë.

103 Cf. fusnota 43,44, **supra** , në këtë pjesë të librit, si dhe komentet tona aty.
104 Cf. fusnota 44, **supra**, në këtë pjesë të librit, si dhe komentet tona aty.

Ligji për vetëqeverisjen lokale ka përcaktuar mekanizmat e pjesëmarrjes së qytetarëve në **demokracinë e drejtpërdrejtë**, në nivelin lokal. Mekanizmat e pjesëmarrjes së qytetarëve në demokracinë e drejtpërdrejtë në nivelin lokal janë:

- informimi publik dhe konsultimi;
- e drejta e peticionit;
- iniciativat qytetare;
- referendumi;
- pjesëmarrja në procedurën shkarkimit të kryetarit; dhe, së fundi,
- komitetet konsultative.

Konsultimi publik, është njëra ndër format e ushtrimit të demokracisë së drejtpërdrejtë nga qytetarët në nivelin lokal, duke i dhënë mundësi atyre që të jenë pjesë e vendimeve në nivel të komunës. Secila komunë është e obliguar që të mbajë minimalisht dy (2) herë në vit takime publike, ku mund të marrë pjesë secili person fizik ose organizatë, me interes në komunën përkatëse. Qëllimi i takimeve të tilla dhe konsultimeve publike është informimi i qytetarëve, për aktivitetet e komunës.

Në këto takime qytetarët dhe të gjithë pjesëmarrësit kanë të drejtë të shtrojnë pyetje dhe të japin propozime konkrete, për përfaqësuesit e zgjedhur komunalë. Në kuptim të realizimit të parimit të transparencës dhe demokracisë së drejtpërdrejtë lokale, komunat janë të obliguara t'i informojnë qytetarët e komunës përkatëse, për çfarëdo plani me interes publik për qytetarët. Transparenca në komuna është një ndër parimet bazike të komunikimit me qytetarë dhe të vendimmarrjes së një komune. Ministria përgjegjëse për qeverisjen lokale në Republikën e Kosovës ka nxjerr akte nënligjore sa i përket transparencës në komuna. Nga ministria përkatëse, me qëllim të rregullimit të konsultimit publik dhe informimit në komuna, nxirren aktet të cilat rregullojnë këto çështje dhe të cilat akte kanë vlefshmëri për të gjitha komunat.

Konsultimi publik, si mënyrë e realizimit të demokracisë së drejtpërdrejtë lokale, zhvillohet duke u bazuar në disa **parime kryesore** siç janë:

- parimi i ligjshmërisë;
- parimi i transparencës;
- parimi barazisë dhe mosdiskriminimit;
- parimi i efikasitetit në procesin e konsultimit publik.

Komuna duhet t'i sigurojë qytetarët se të gjitha projektpropozimet shpallen në ueb-faqen e komunës si dhe në platformën qendrore për konsultime publike. Të gjitha projektpropozimet e komunës, të cilat i nënshtrohen konsultimit publik duhet të jenë të qarta dhe të kompletuara në të gjitha dokumentet përcjellëse. Në konsultim publik nga komuna detyrimisht vendosen të gjitha dokumentet e politikave lokale si në vijim:

- planin vjetor të punës së kuvendit të komunës dhe ekzekutivit;
- projektbuxhetin e komunës për vitin vijues;
- kornizën afatmesme të shpenzimeve për tri (3) vitet e ardhshme;
- strategjinë zhvillimore dhe planet e veprimit në nivel lokal, në kuadër të fushave sektoriale;
- të gjitha planet hapësinore në nivel lokal;
- statutin e komunës;
- projektrregulloret komunale;
- të gjitha dokumentet e tjera për të cilat komuna e vlerëson se janë të nevojshme të kalojnë në konsultim publik;
- çfarëdo dokumenti tjetër të paraparë me ligjet e zbatueshme dhe që i nënshtrohet konsultimit publik.

Përgjegjës për koordinimin e procesit për konsultimin publik në një komunë është **zyrtari për komunikim publik**, i cili ka detyrë kryesore që ta koordinojë këtë proces në të gjitha fazat. Konsultimi zhvillohet në forma të caktuara, të cilat janë për sa vijon:

- takimet publike konsultative;
- konsultimet me shkrim, në formë elektronike;
- publikimet në ueb-faqen e komunës;
- publikimet në platformën qendrore për konsultime publike;
- publikimet në platforma elektronike shtesë;
- konferencat;
- këshillimet me grupe të caktuara të interesit;
- intervistat;
- analizat dhe opinionet;
- panelet me qytetarë;
- stendat në rrugë;
- takimet me këshillat e fshatrave, lagjeve dhe vendbanimeve urbane.

Konsultimet nëpërmes ueb-faqes dhe format e tjera të konsultimeve publike, që mbahen në mënyrë elektronike, janë të obligueshme. Konsultimi publik nëpër komuna mbahet në **disa faza**, të cilat janë për sa vijon:

- faza e planifikimit të konsultimeve publike;
- faza e mbajtjes së konsultimeve publike; dhe, së fundi,
- mbledhja e komenteve dhe adresimi i tyre në organet përgjegjëse komunale.

Në të gjitha fazat, konsultimi mund të zgjas jo më pak se tridhjetë (30) ditë dhe jo me shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë nga dita e njoftimit për konsultime publike. Në kuadër të këtij afati nuk llogaritet faza e tretë e realizimit të konsultimeve publike, që është faza e mbledhjes dhe adresimit të komenteve, nga procesi i konsultimit publik. Në kuptim të realizimit të mbikëqyrjes, për përmbushjen e standardeve minimale për konsultimin publik nëpër komuna, **ministria përkatëse për qeverisje lokale** harton **raport vjetor** për plotësimin e standardeve minimale, në procesin e konsultimit publik.

Realizimi i parimit të transparencës dhe qasjes së qytetarëve në komuna, nënkupton obligimin e të gjitha komunave, që ndaj qytetareve dhe palëve tjera të interesuara të bëjnë transparente dhe të qasshme aktivitetet e tyre. Një formë e realizimit të **transparencës komunale** është **hapja e mbledhjeve të organeve të qeverisjes komunale**, siç janë mbledhjet e kuvendit të komunës dhe mbledhjet e komiteteve komunale. Mbledhjet e kuvendit të komunës dhe komiteteve **janë të hapura për qytetarët dhe publikun e gjerë**. Kryesuesi i kuvendit të komunës ose komiteteve përkatëse, çdo herë **duhet ta njoftojë publikun**, të paktën shtatë (7) ditë pune për mbledhjet e rregullta dhe tri (3) ditë pune për mbledhjet e jashtëzakonshme përmes:

- shpalljeve publike;
- mjeteve të shkruara dhe elektronike;
- ueb-faqes zyrtare të komunës, etj.

Njoftimi duhet të ketë kohen dhe vendin e mbledhjes si dhe rendin e ditës. Përveç kësaj, komuna përkatëse **duhet t'i bëjë publike** edhe të gjitha **vendimet, rregulloret dhe dokumentet e tjera të cilat nuk kufizohen sipas Ligjit për qasje në dokumente publike**. Komuna obligohet që t'i publikojë në ueb -faqen zyrtare edhe dokumentet si vijon:

- planin buxhetor dhe planet investuese;
- raportet tremujore të shpenzimeve buxhetore;

- kornizën afatmesme të buxhetit;
- raportin përmbledhës të buxhetit për vitin e kaluar fiskal;
- raportin e auditorit për vitin paraprak, etj.

Qytetarët e komunës përkatëse kanë të drejtë të informohen edhe për të gjitha **takimet publike të komunës**, të cilat mbahen nga komuna. Njoftimi lidhur me takimet publike të komunës bëhet përmes: shpalljeve publike; mediave të shkruara dhe elektronike; ueb-faqes së komunës etj. Duhet të publikohet vendi dhe koha e mbajtjes së takimit, si dhe rendi i ditës. Pjesë e realizimit të **transparencës komunale** janë edhe **takimet e kryetarit të komunës** me qytetarët. Këto takime kanë për qellim njoftimin e drejtpërdrejtë me problemet me të cilat ballafaqohen qytetaret në komunën përkatëse. Të gjitha vendimet e kryetarit të komunës, që prekin interesat e qytetarëve duhet të jenë publike dhe të shpallen në ueb-faqen e komunës dhe të ministrisë përkatëse për pushtetin lokal.

Qytetarët e komunës duhet të informohen dhe të konsultohen edhe para miratimit të **akteve komunale**, në komunën përkatëse. Secila komunë, e ka për obligim ta hartojë **planin e veprimit për transparencë**, të cilin pas miratimit nga kuvendi komunal e publikon në ueb-faqe. Ky plan duhet të përfshijë:

- mbledhjet e kuvendit komunal;
- mbledhjet e komiteteve;
- takimet publike;
- takimet konsultative;
- takimet obligative në media për çështje që lidhen me buxhetin e komunës;
- shpalljet publike në vendet e frekuentuara;
- takimet me grupe të interesit për të diskutuar çështje të caktuara të sigurisë në bashkësi;
- qasjen transparente dhe të shpejtë për qytetarët;
- transparencën në lidhje me prokurimin publik;
- procedurat transparente të punësimit;
- publikimi i aktiviteteve në ueb-faqen zyrtare; procedura transparente në vendimmarrje etj.

Një mekanizëm i rëndësishëm i pasqyrimit të transparencës së komunave është **ueb-faqja**, ku arritja deri tek informacionet e publikuara nga komunat përkatëse duhet të jetë e qasshme me sa më pak hapa apo klikime.

E drejta e peticionit është një ndër mekanizmat e tjerë të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje në komunat e Republikës se Kosovës: çdo person apo organizatë me interes në komune ka të drejtën e **prezantimit të peticionit në kuvendin e komunës** për çfarëdo çështje lidhur me përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës. Kuvendi i komunës, shqyrton peticionin në pajtim me statutin dhe rregulloren e punës, duke marrë parasysh vetëm peticionet që kanë të bëjnë me fushën e përgjegjësive komunale dhe në asnjë mënyrë peticionet që kane të bëjnë dhe që janë jashtë përgjegjësive komunale. Duhet të theksohet se secila komunë në Republikën e Kosovës e ka rregulluar me statutin e saj procedurën e shqyrtimit të peticionit dhe mënyrën e trajtimit te tij nga ana e komunës përkatëse.

Një tjetër mekanizëm i rëndësishëm i pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje në komunë është **iniciativa qytetare**. Qytetaret e secilës komunë mund të marrin iniciativë për të propozuar **rregullore** për miratim në kuvend apo me votën e qytetarëve. Propozuesit, duhet t'ia dorëzojnë rregulloren e propozuar kryesuesit të kuvendit të komunës. Rregullorja e propozuar nga ana e qytetarëve duhet të nënshkruhet nga 15% e votuesve të regjistruar në komunën përkatëse, me qellim të shqyrtimit në kuvendin e komunës. Kuvendi më pas është i obliguar që rregulloren ta shqyrtojë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh. Statutet përkatëse të komunave në Republikën e Kosovës, përcaktojnë më shumë detaje lidhur me iniciativën qytetare për të propozuar rregullore në kuadër të kompetencave të komunës.

Ligji për vetëqeverisje lokale njeh edhe **referendumin**, si formë të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje. Ligji përcakton se **referendumi në komunën përkatëse mund të mbahet vetëm për rregullore të kuvendit të komunës**. Kërkesa për miratim të rregullores të kuvendit të komunës me referendum nënshkruhet nga të paktën 10% të votuesve dhe i dorëzohet kryesuesit të kuvendit. Në këtë rast, kuvendi i komunës e shqyrton këtë çështje brenda tridhjetë (30) ditësh. Statuti i komunave të caktuara, megjithatë, parasheh mundësinë që komunat

Të organizojnë **referendum** edhe për çështje tjera. Kështu, ta zëmë, **Statuti i Komunës se Vushtrrisë**, përcakton ndër të tjera se për çështjet që janë në interes të komunës dhe interesave të saj, kuvendi i komunës mund të mbaj referendum. Në këtë komunë, referendumi konsiderohet i suksesshëm, nëse votojnë "për" shumica e qytetarëve me të drejtë vote që kanë marrë pjesë në referendum.

Formë e ushtrimit të demokracisë së drejtpërdrejtë lokale dhe vendimmarrjes se qytetareve është edhe **instituti i largimit të kryetarit të komunës**. Kërkesa për largimin e kryetarit te komunës duhet të nënshkruhet nga 20% e votuesve të regjistruar dhe e njëjta i dorëzohet kryesuesit të kuvendit te komunës. Nëse shumica e votuesve të regjistruar votojnë për largimin e kryetarit, shpallen zgjedhjet e reja. Zgjedhjet e reja për kryetar të komunës, mbahen jo më vonë se tridhjete (30) ditë pas përfundimit të mandatit të kryetarit të komunës.

Qytetarët marrin pjesë në vendimmarrje edhe **përmes komiteteve të caktuara**, të cilat i themelon një komunë përkatëse. Komitetet e komunës ku marrin pjesë qytetarët dorëzojnë propozime, bëjnë hulumtime dhe ofrojnë mendime për iniciativat e kuvendit të komunës, në pajtim me statutin e komunës përkatëse.

Pushteti qendror ka një **raport** të caktuar me pushtetin lokal, i përcaktuar me Ligjin për qeverisjen lokale dhe konsiston në të **drejtën e mbikëqyrjes dhe kontrollit administrativ të qeverisjes lokale** nga ana e pushtetit qendror. Kjo mbikëqyrje e pushtetit lokal bëhet nga ana e **ministrisë përkatese për qeverisje lokale**: mbikëqyrja e komunave nga ana e pushtetit qendror është **mbikëqyrje administrative**. Shqyrtimi administrativ ka disa objektiva te cilat i përcakton **Ligji për vetëqeverisjen lokale** dhe kanë të bëjnë me sa vijon:

- forcimi i aftësisë së organeve të vetëqeverisjes lokale për përmbushjen e përgjegjësive të tyre përmes këshillimit, mbështetjes dhe ndihmës;
- sigurimi i ligjshmërisë së aktiviteteve të organeve te vetëqeverisjes lokale;
- sigurimi që të drejtat dhe interesat e qytetarëve respektohen.

Shqyrtimi administrativ nga ana e pushtetit qendror, gjithnjë bëhet në pajtim me KKos dhe Ligjit për vetëqeverisjen lokale dhe në asnjë mënyrë nuk mund t'i tejkaloje parimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Shqyrtimi dhe mbikëqyrja administrative e komunave nuk mund t'i cenojë dhe kufizojë të drejtat e komunave dhe autoriteteve të tjera lokale në menaxhimin e çështjeve të cilat i kanë të garantuara me ligj. Aktiviteti i mbikëqyrjes së komunave bëhet nga ana e ministrisë përkatëse për qeverisje lokale. Kryetari i komunës duhet t'u në në dispozicion të gjitha informatat autoriteteve mbikëqyrëse, në kuadër të procesit të mbikëqyrjes së komunave në Republikën e Kosovës.
Ekzistojnë **dy lloje** të **shqyrtimit dhe mbikëqyrjes administrative** të komunave dhe atë:

- shqyrtimi në fushën e kompetencave vetjake, të zgjeruara që kufizohet në shqyrtimin e ligjshmërisë; dhe
- shqyrtimi në fushën e kompetencave të deleguara, që ka të bëjë me shqyrtimin e ligjshmërisë dhe përshtatshmërisë (oportunitetit) së veprimeve.

Përshtatshmëria (oportuniteti) e veprimeve nuk është sqaruar në **Ligjin për vetëqeverisjen lokale**, por nënkupton përshtatshmërinë e veprimeve në raport me veprimet e komunave, të bazuara në legjislacionin në fuqi. Kjo vërtetohet kryesisht duke gjetur nëse veprimi i komunës është ndërmarrë ashtu siç kanë kërkuar autoritetet e pushtetit qendror për kryerjen e punës së deleguar për kryerje në komunë.

Pjesë e rëndësishme e shqyrtimit administrativ të komunave, nga ana e pushtetit qendror, siç u përmend më sipër është **shqyrtimi i ligjshmërisë**. Ligji për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës përcakton **dy lloje te shqyrtimit të ligjshmërisë** dhe atë:

- shqyrtimi i rregullt i ligjshmërisë; dhe
- shqyrtimi i detyrueshëm i ligjshmërisë

Shqyrtimit të rregullt të ligjshmërisë i nënshtrohen të gjitha aktet e komunës, që miratohen nga kryetari dhe kuvendi komunal. Aktet të cilat i nënshtrohen shqyrtimit të rregullt të ligjshmërisë janë akte që janë nxjerr në muajin paraprak dhe të njëjtit duhet të dërgohen për shqyrtim deri më datën dhjetë (10) të çdo muaji. Në anën tjetër, **shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë** i nënshtrohen aktet si në vijim: aktet e përgjithshme të miratuara nga kuvendet komunale; vendimet lidhur me aktivitetet e përbashkëta të partneriteteve për bashkëpunim; aktet e miratuara brenda kornizës së implementimit të kompetencave të deleguara. Të gjitha aktet që i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë i dërgohen **autoritetit mbikëqyrës**, në afat prej shtate (7) ditësh, nga dita e nxjerrjes së tyre. Autoriteti mbikëqyrës bënë shqyrtimin në afat prej 15 ditësh, nga dita e nxjerrjes së aktit. Pas dërgimit të akteve për shqyrtim nga ana e komunës, të njëjtat protokollohen dhe dërgohen në **Departamentin Ligjor për Monitorim të Komunave**, në kuadër të ministrisë përkatëse për vetëqeverisje lokale.

Në rast se organi mbikëqyrës, respektivisht **ministria përkatëse për qeverisje lokale**, konsideron që një akt i nxjerrë nga komuna është në kundërshtim me kushtetutën dhe ligjin, atëherë kërkon nga komuna që ta rishqyrtojë vendimin e tillë. Kërkesa e ministrisë duhet të përmbajë arsyet e supozuara të shkeljes së kushtetutës dhe ligjit si dhe nuk suspendon ekzekutimin e aktit respektiv të komunës. Komuna përkatëse, duhet t'i përgjigjet kërkesës së ministrisë për rishqyrtimin e aktit, në afat prej tridhjete (30) ditësh. Në rast se komuna e pranon kërkesën për rishqyrtimin e aktit të caktuar, atëherë vetë komuna mund ta pezullojë zbatimin e aktit në fjalë. Në anën tjetër, në rast se komuna nuk përgjigjet brenda aftit prej tridhjete (30) ditësh, atëherë organi mbikëqyrës, respektivisht Ministria për Vetëqeverisje Lokale adreson aktin e komunës në gjykatën kompetente, brenda territorit të komunës përkatëse.

Përveç situatës së **shqyrtimit të akteve në momentin e nxjerrjes së tyre**, komuna përkatëse ka mundësi që të kërkojë edhe **shqyrtimin paraprak të akteve komunale** nga ministria kompetente për qeverisje lokale. Me këtë rast, ministria duhet t'i kthejë përgjigje komunës në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Përveç mbikëqyrjes së **kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë**, ministria përkatëse bënë mbikëqyrjen e përshtatshmërisë së akteve. Nëse organi komunal nuk vepron sipas kërkesës së ministrisë, atëherë ministria si organ mbikëqyrës mund ta modifikojë, zëvendësojë apo pezullojë aktin e komunës. Të gjitha ankesat e qytetareve lidhur me një akt të komunës shqyrtohen sipas **Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative në Republikën e Kosovës**.

Në kontekst të kontrollit të komunave nga ana e organeve qendrore, është e rëndësishme të theksojmë se kuvendi i Republikës së Kosovës, Presidenti, qeveria dhe Avokati i Popullit kanë të drejtë të ngrenë në GJKRKS përputhshmërinë e statutit të komunës me kushtetutën. Kjo kompetencë, i jep mundësi organeve kryesore të shtetit që përmes GJKRKS të vlerësohet nëse statuti i një komune përkatëse është në përputhshmëri me dispozitat e KKos. Deri në shkrimin e këtyre rreshtave (maj 20023), që nga themelimi i GJKRKS nuk ka pasur ndonjë rast kur organet qendrore kanë ngritur përputhshmërinë e statutit të një komune me KKos.

E drejta për një autonomi (mëvetësi) të madhe të autoriteteve lokale garantohet me KKos dhe tutje përpunohet me Ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe ligjet e tjera të aplikueshme. Autonomia lokale të cilën e garanton KKos është e dukshme kur analizohen kompetencat e komunës, sidomos ato vetjake dhe të zgjeruara, por edhe kompetencat e organeve komunale. KKos dhe Ligji për vetëqeverisjen lokale kanë përcaktuar mekanizma përmes të cilëve mund të mbrohet autonomia lokale. Një mekanizëm i tillë është përmes GJKRKS. Komuna si person juridik, me qellim të mbrojtjes së autonomisë lokale është e autorizuar që të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve dhe të gjitha akteve të qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt i caktuar (neni 113.4 i KKos). Secila komunë, pra, mund ta mbrojë **autonominë e saj administrativo-politike**, duke kontestuar kushtetutshmërinë e ligjeve dhe të gjitha akteve të tjera të Qeverisë, që cenojnë përgjegjësitë e saj, të cilat përcaktohen me ligj. Përveç kësaj, komuna mund të mbrojë **autonominë financiare** të saj, nëse ligji apo akti i kontestuar cenon të hyrat e komunës, të cilat garantohen me KKos dhe Ligjin për vetëqeverisjen lokale. Se çka duhet të përmbajë kërkesa, afati për paraqitjen dhe koha për dhënien e vendimit përcaktohen me **Ligji Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës se Kosovës**, Në këtë ligj përcaktohet se, në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 4 të KKos, komuna paraqet, ndër të tjera, informatat përkatëse ne lidhje me ligjin apo aktin e kontestuar të qeverisë, përkatësisht se cila dispozitë kushtetuese është shkelur dhe cilat përgjegjësi apo të hyra komunale janë prekur nga një ligj apo akt i tillë. Kërkesa duhet të dorëzohet brenda një (1) viti pas hyrjes ne fuqi të dispozitës ligjore apo aktit të qeverisë që kontestohet nga ana e komunës. Deri më tani asnjë komunë nuk ka kontestuar ligjet apo aktet e qeverisë, nën supozimin se është shkelur autonomia e tyre financiare apo përgjegjësitë e tyre.

Një ndër palët e autorizuara në **GJKRKS**, për të mbrojtur të drejtat e komuniteteve në komunën përkatëse është edhe **zevëndëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete**. Kjo mund të bëhet nëse një akt i caktuar që miratohet nga kuvendi i komunës shkel te drejtat e komuniteteve të cilat garantohen me KKos. Ky autorizim përcaktohet me **Ligjin për vetëqeverisjen lokale**. Mbi këtë bazë juridike, më datë 22 prill 2009, zevendeskryesuesi i kuvendit të Komunës së Prizrenit z. **Qemajl Kurtishi**, ka parashtruar kërkesë, që u diskutua më sipër. Në këtë rast, **Rasti KO 01/09**, sikundër u tha, GJKRKS gjeti se ishte bërë një shkelje e të drejtave të komuniteteve joshumicë në Prizren për të ruajtur, mirëmbajtur dhe promovuar identitetin e tyre. Për rrjedhojë, ajo dha urdhër që neni 7 i Statutit të Komunës se Prizrenit (dukja e emblemës së Komunës) të ndryshonte, në mënyrë që dukja e emblemës të ishte në përputhshmëri me kushtetutën dhe të mos përjashtonte komunitetet joshumicë në komunën e Prizrenit.

Fare në fund ngelet **çështja e kryeqytetit** të Republikës së Kosovës. Neni 13 i KKKos përcakton se kryeqytet i Republikës se Kosovës është Prishtina dhe se statuti dhe organizimi i kryeqytetit rregullohet me ligj. Vetëm dhjetë vite pas hyrjes ne fuqi të KKKos, Kuvendi i Republikës se Kosovës ka arritur të miratojë **Ligji nr. 06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës se Kosovës**, përkundër që ky ishte një obligim kushtetues që nga viti 2008. Kryeqyteti ka statusin e personit juridik dhe është njësi e vetëqeverisjes lokale me status dhe organizim të veçantë, që ushtron kompetenca brenda territorit të tij. Kryeqyteti historik i Republikës së Kosovës është **Prizreni** (neni 4.2 i **Ligjit nr. 06/L-012**). Kryeqyteti i Republikës së Kosovës, **përveç kompetencave të përcaktuara** me Ligjin për vetëqeverisje lokale, ushtron kompetenca edhe në fushën e **sigurisë publike**, **shërbimeve publike** dhe kompetenca në **mbrojtjen shëndetësore**.

Kompetencat e kryeqytetit nga fusha e **sigurisë publike** janë:

- Policia e Kosovës themelon **Drejtorinë e Policisë për Kryeqytetin**, organizimi dhe funksionimi i së cilës rregullohet me **Ligjin për Policinë**, e cila do të ketë kompetencë vetëm në territorin e kryeqytetit;
- kryetari i kryeqytetit, pas aprovimit nga kuvendi i kryeqytetit, i propozon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, minimumin dy (2) kandidatë për drejtorë të **Drejtorisë së Policisë për**

Kryeqytetin;
- kuvendi i kryeqytetit ushtron mbikëqyrjen e politikave lokale të sigurisë të cilat bien në kompetencë të kryeqytetit;
- kuvendi i kryeqytetit ka të drejtë të kërkojë nga drejtori i **Drejtorisë së Policisë për Kryeqytetin** të informoj lidhur me gjendjen e sigurisë në kryeqytet;
- me kërkesën e kryetarit të kryeqytetit, **Policia e Kosovës**, në pajtim me **Ligjin për Policinë**, themelon njësitë të veçanta duke u bazuar në nevojat e kryeqytetit;
- këshilli i kryeqytetit për siguri në bashkësi është organ këshillëdhënës përgjegjës për koordinimin ndërinstitucional lidhur me çështjet e sigurisë në kryeqytet, detyrat dhe përgjegjësitë e të cilit janë të përcaktuara me akte nënligjore.

Në një raport të **Avokatit te Popullit**, i regjistruar si rasti **A.nr.683/2018,** kontestohen kompetencat e kryeqytetit të Republikës së Kosovës në fushën e sigurisë, respektivisht ato të përcaktuara në nenin 7 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i **Ligjit nr. 06/L-012**. Sipas këtij raporti, neni 7 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 i **Ligjit nr. 06/L-012** bie ndesh me **Ligjin për Policinë**, sepse themelimi i Drejtorisë së Policisë për Kryeqytetin përbën një përzierje dhe ndërhyrje në organizimin e policisë. Ndërkaq, sipas raportit në fjalë, ligji i cili rregullon organizimin e policisë është Ligji per Policinë. Raporti i Avokatit të Popullit, evidenton ndër të tjera se dy (2) ligje nuk mund ta rregullojnë të njëjtën çështje dhe se në këtë rast, do të duhej të vlente parimi se ligji special përjashton ligjin e përgjithshëm. Ne rastin konkret, Avokati i Popullit, konstaton se ligji special është **Ligji për Policinë** dhe se **Ligji për Prishtinën** do të duhej t'i përshtatej Ligjit për Policinë. Ne kontekst të kësaj, Avokati i Popullit, po ashtu, rekomandon që të bëhet plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për Prishtinën dhe i njëjti të harmonizohet me **Ligjin për Policinë**, në aspektin e gjetjeve në raportin e tij. Ky rekomandim i Avokatit të Popullit deri më sot ka rënë në vesh të shurdhër.[105]

Kompetencat e kryeqytetit në fushën e **mbrojtjes shëndetësore** janë:

- kryeqyteti ka kompetenca për ofrimin e përkujdesit dytësor shëndetësor;
- kryeqyteti themelon spitalin e përgjithshëm të kryeqytetit, funksionimi dhe organizimi i të cilit rregullohet me legjislacionin përkatës në fuqi.

Kompetencat e kryeqytetit në fushën e **shërbimeve publike** janë:

- kryeqyteti sipas nevojës themelon dhe menaxhon ndërmarrje publike lokale që shërbejnë vetëm për territorin e kryeqytetit;
- themelimi i ndërmarrjes së re publike lokale në kryeqytet bëhet me propozim të kryetarit të kryeqytetit, i shoqëruar me planin e biznesit dhe analizën financiare dhe miratohet nga kuvendi i kryeqytetit;
- procedurat për themelimin e ndërmarrjes publike lokale të kryeqytetit nuk kërkojnë marrjen e pëlqimit nga qeveria;
- vendimi për themelimin e ndërmarrjeve publike lokale merret me dy të tretat (2/3) e votave të anëtarëve të kuvendit të kryeqytetit.

Çështja e zgjedhjeve, mandatit dhe përbërjes së organeve komunale në **Ligjin nr. 06/L-012** është i njëjtë me zgjidhjet ligjore të Ligjit për vetëqeverisjen lokale. Për dallim nga komunat e tjera, kryeqyteti i Republikës se Kosovës ka dy nënkryetarë, të cilët i emëron kryetari i kryeqytetit, i cili, në të njëjtën

[105] Cf.më shumë në **Raport me rekomandime i Avokatit të Popullit, rasti nr.683/2018,** në lidhje me Ligjin 06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, përkatesisht nenin 7 paragrafi 1, i cili rregullon sigurinë publike si kompetencë e kryeqytetit. Për komentet shtesë të kësaj tematike, cf. edhe Visar Morina, Florent Mucaj, Entela Nikaj, Jeton Shasivari dhe Luz Balaj, *VETËQEVERISJA LOKALE: Shqyrtime teorike dhe krahasimore* (Fondacioni-Konrad-Adenauer ne Republiken e Kosoves: Prishtinë, 2021).

kohë, mund të emërojë deri në pesë (5) këshilltarë. Sa i përket buxhetit të kryeqytetit të Republikës së Kosovës, vlen **Ligji** për financat e pushtetit lokal, i cili, siç e kemi thënë më sipër, përcakton mënyrën e financimit të komunave. Për dallim nga komunat e tjera, kryeqytetit i jepet një grant shtesë, në jo me pak se 6% i grantit të përgjithshëm të komunave, të përcaktuar me **Ligjin për financat e pushtetit lokal**. Burimet e financimit te kryeqytetit janë të njëjta me ato të komunave të tjera, siç është sqaruar më sipër.

11.2. Shqipëria

11.2.1. Historiku

Në trajtimet tona të këtij seksioni, lidhur me vetëqeverisjen lokale në Shqipëri, e cila quhet **vetëqeverisje vendore**, gjerësisht jemi mbështetur në dy botimet e librit të konstitucionalistëve të njohur shqiptarë, **Luan Omari** dhe **Aurela Anastasi**.[106]

Shteti i pavarur shqiptar ka filluar jetën e tij, përmes ligjeve për organizimin e pushtetit vendor, gjë që dëshmon konceptet e drejta të klasës politike të kohës, për rëndësinë e organizimit të qeverisjes vendore në shtet. Një nga aktet e para të tij, "Kanuni i përtashëm i administratës civile të Shqipërisë", i miratuar më 22 nëntor 1913, përfaqëson një nga aktet më të rëndësishme që u miratuan nga **Qeveria e Vlorës**. Ky akt, për herë të parë sanksionoi me hollësi ndarjen e re administrative të Shqipërisë dhe rregulloi kompetencat e organeve përkatëse sipas përvojave perëndimore, larg nga praktikat e vjetra otomane. Në bazë të tij, Shqipëria ndahej në prefektura, nënprefektura dhe krahina të cilat drejtoheshin nga prefekti, nënprefekti dhe krahinari. Pranë tyre vepronin edhe këshilla të cilat ishin organe të zgjedhshme nga populli, u mor vesh sipas sistemit të zgjedhjeve të tërthorta, ku përjashtoheshin femrat dhe vota e lirë dhe e fshehtë e drejtpërdrejtë (ky standard ka qenë në fuqi në krejt vendet e Evropës dhe më gjerë në këtë kohë).

Sikundër dihet, një prej parimeve më moderne të qeverisjes vendore, ai i decentralizimit, ishte afirmuar nga rilindasi ynë kombëtar **Sami Frashëri** (1850-1904) qysh në vitin 1899, në veprën e tij **Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet**. Kur shkruante për organizimin lokal të Shqipërisë së pavarur, të ndarë në njësitë territoriale (ngastra, nëngastra dhe katundari), **Sami Frashëri** theksonte, ndër të tjera, se "[...] M'i lumtur i vendeve në botë është' ay tek ndjehetë fort pak dor' e qeverisë" dhe "[...] Sa të mundetë, qeverisja të mos ketë të bëjë drejtpërdrejtë me vendasit".[107] Me qeverisje, **Sami Frashëri** këtu nënkupton qeverinë qendrore. Ideja themelore e tij është ajo për një shtet minimal, narrativ ky i liberalëve të kohës në **SHBA** dhe gjetiu nëpër **Evropë**, që sot e kësaj ditë konceptualisht ka ngelur i njëjtë: që shteti të jetë sa më pak ndërhyrës në jetën dhe punën e shtetasve të vet, të shërbej si një servis dhe rregullatorë i jetës dhe punës së tyre. Kjo, shikuar nga prizmi i vetëqeverisjes vendore, nënkupton që shërbimi i autoritetit publik të jetë sa më afër qytetarit, që ai të ndihet i lirë në botën e vetë çdoherë kur ndeshet me autoritetin publik.

Shteti shqiptar është krijuar si **shtet unitar** dhe ka mbetur historikisht i tillë. Raporti ndërmjet pushtetit qendror dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, megjithatë, është paraqitur i ndryshëm në periudha të caktuara historike. Fillimisht, kur u krijua si një shtet i pavarur, ai u frymëzua nga idetë dhe organizimet më të përhapura të kohës. Megjithatë, deri në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, legjislacioni shqiptar nuk krijonte **decentralizimin e dëshiruar**, përkundër faktit që në strukturat e tij normative kishte hapësirë për një gjë të tillë. Në këtë periudhë u ruajt një pushtet përgjithësisht i centralizuar, cilësi kjo e të gjitha monarkive ballkanike të kohës, i përshtatshëm për t'u përgjigjur interesave të një shteti jodemokratik dhe autoritar, përkundër përpjekjeve për liberalizim politik dhe ekonomik. Kjo praktikë

[106] Luan Omari dhe Aurela Anastasi, *E drejta kushtetuese* ("Dajti 2000": Tiranë, 2010); Luan Omari dhe Aurela Anastasi, *E drejta kushtetuese* ("Dajti 2000": Tiranë, 2017).

[107] Sami Frashëri, *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet* (Rilindja: Prishtinë, 1978), fq. 100.

jodemokratike dhe autoritare, siç u tha, ka qenë prezente në të gjitha monarkitë ballkanike, të cilat në kushtetutat e tyre proklamonin veten si monarki kushtetuese, në një kohë që pushteti i monarkut ishte i pakufizuar dhe burim i krejt strukturave normative të shtetit.[108]

Sa i përket periudhës pas rënies së Shqipërisë nën sundimin komunist, nuk mund të bëhet fare fjalë për një vetëqeverisje vendore, pasi gjithçka i nënshtrohej dhe i bindej qendrës nën mburojën e parimit të "centralizmit demokratik". Kjo bëhej e mundur ngaqë të gjitha kushtetutat komuniste kanë garantuar rolin dhe pozitën superiore të partisë komuniste në të gjitha poret e jetës përfshirë nivelin lokal të qeverisjes. Kanë qenë qëndrimet e partisë komuniste, jo mëvetësia e qeverisjes vendore, ajo që ka çuar peshë. Kështu ka qenë edhe në Kosovë dhe në të gjitha vendet komuniste. Kjo gjendje rrënjësisht ka ndryshuar me rënien e komunizmit dhe mbarimin e Luftës së Ftohtë, kur Shqipëria u orientua kah vlerat e konstitucionalizmit liberal perëndimor. Pas kësaj kohe, edhe vetëqeverisja vendore mori domethënie kuptimplotë dhe u modelua sipas standardeve më të larta evropiane të fushës së vetëqeverisjes në fjalë.

11.2.2. Ndikimi i standardeve ndërkombëtare në qeverisjen vendore

Demokratizimi dhe racionalizimi i qeverisjes vendore, afirmimi i parimit të vetëqeverisjes vendore etj., u shndërruan në çështjet më themelore të shtetit Shqiptar gjatë periudhës së tranzicionit demokratik. Sikundër dihet, nuk pati një kushtetutë të shkruar që kodifikonte materien kushtetuese në një vend të vetëm, në ndërkohë që kushtetutat e ish-sistemit komunist kishin rënë në humnerën e historisë si dështime serioze për të shërbyer si instrumente juridike mbi kufizimin e pushtetit shtetëror. U nxorën dispozita me karakter normativ kushtetues, që kishin natyrën e një ligji të zakonshëm, por në të cilin u përmblidhen dispozitat kryesore kushtetuese të vendit.[109] Këto dispozita kanë qenë në fuqi deri më 28 tetor 1998, kur u nxor Kushtetuta e Shqipërisë (KShq), aktualisht në fuqi. Në **Ligjin për dispozitat kryesore kushtetuese** (LDKK), parimet bazë të qeverisjes vendore u sanksionuan në një shtojcë të posaçme, që titullohej "Për organizimin e funksiononin e pushtetit lokal", dhe që u fut si shtojcë e **LDKK**.

Në themel të legjislacionit të ri shqiptar, pas rënies së komunizmit, u vendosën standardet e arritura nga bashkësia ndërkombëtare, të cilat u mishëruan në **KEVL**, parimet kryesore të së cilës detyrojnë shtetet të respektojnë autonominë dhe pavarësinë e pushtetit vendor. Më pas, këto parime u shndërruan në parime bazë të Shtetit shqiptar. Një nga arritjet më të mëdha të KEVL qëndron në faktin se ajo e ka shndërruar vetëqeverisjen vendore në një vlerë të përbashkët të shteteve të Evropës, të lidhur ngushtë me nivelet e demokracisë dhe të respektimit të të drejtave të njeriut në këto vende. Për pasojë, modelet e shteteve të përparuara evropiane u bënë një ndihmesë e e rëndësishme për krijimin e një modeli të ri shqiptar, në një terren të virgjër i sapodalë nga skëterra komuniste. KEVL-ja ofroi për Shqipërinë një koncept të qartë të vetëqeverisjes vendore, duke renditur elementet themelore të saj, të cilët konsistojnë në sa vijon:

- vetëqeverisja lokale duhet të ekzistoj në çdo shtet palë;
- në vetëqeverisjen lokale duhet të ekzistojnë organet vendimmarrëse, të formuara në mënyrë demokratike;
- vetëqeverisja duhet të jetë e gjerë në pikëpamje të kompetencave dhe ushtrimit të tyre në mënyrë autonome, përfshirë këtu pasjen e mjeteve të duhura financiare për përmbushjen e misionit të organeve të kësaj bashkësie vendore.

Hartuesit e **KShq** preferuan një rrugë të mesme në çështjet e kushtetutëzimit të organizimit dhe funksionimit të pushtetit vendor. Kjo rrugë nënkupton normimin kushtetues vetëm të bazave dhe parimeve të vetëqeverisjes vendore, duke ia lënë ligjvënësit shqiptar operacionalizimin e mëtejmë të kësaj ma-

[108] Cf. më shumë në Barbara Jelavich, *History of the Balkans. Twentieth Century*. Volume 2 (Cambridge University Press: Cambridge, 1983), fq. 13-50; Tom Gallagher, *Outcast of Europe: The Ballkans 1789-1989* (Routledge: London and New York, 2001), fq. 72-126.

[109] **Ligji nr 7491, datë 29.4.1991 për dispozitat kryesore kushtetuese.**

terie. Nuk do mend se kjo qasje është më praktike sesa, ta zëmë, zgjidhja kushtetuese italiane, e cila me kushtetutë normon në mënyrë bukur të detajuar çështjen e vetëqeverisjes lokale, ashtu që kur duhet të bëhet ndonjë ndryshim në praktikat e kësaj qeverisjeje, duhet të ndryshoj kushtetutën. KShq afirmon parimet e organizimit dhe fiunskionimit demokratik të qeverisjes vendore: në nenin 13 ("Parimet themelore") thuhet se "Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizmit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore". Në pjesën e gjashtë të KShq flitet gjerësisht për qeverisjen vendore, organizimin dhe funksionimin e saj mbi bazën e parimeve themelore të karakterit demokratik. Aty sigurohet një garancion për vetëqeverisjen vendore, përmes sanksionimit të parimit sipas të cilit "vetëqeverisja në njësitë vendore ushtrohet nëpërmjet organeve të tyre përfaqësuese dhe referendumeve vendore". (neni 108.4 i **KShq**). Është e kuptueshme që ky garancion shoqërohet me kufizimet e tij të kushtëzuara nga pandashmëria e Republikës. Parimi i përfaqësimit, që shpreh karakterin demokratik të organeve vendore, sanksionohet në nenin 109 të KShq. Me këtë bëhet e qartë se KShq jo vetëm që është burim i ekzistencës së organeve të qeverisjes vendore, por njëkohësisht edhe një normë që disiplinon e përcakton konkretisht pushtetet dhe kompetencat e tyre. Këto norma e parime bazë kushtetuese nuk mund të jenë frytdhënëse pa u operacionalizuar më tutje me dispozita ligjore, sepse vetëm normat kushtetuese nuk mjaftojnë për një gjë të tillë. Kjo bëhet me ligjin organik që normon këtë materie,[110] i cili është miratuar dy muaj pas hyrjes në fuqi të KShq.

11.2.3. Organizimi i qeverisjes vendore

KShq sanksionon si njësi të vetëqeverisjes vendore **komunat** dhe **bashkitë**. Si të tilla, ato ndërtohen mbi parime demokratike: pranë tyre vepron këshilli përkatës si organ kolegjial i zgjedhur nga populli me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta e të fshehta (neni 109.1 i KShq). Edhe organi ekzekutiv që qëndron në krye të dy njësive bazë të qeverisjes, (kryetari i komunës dhe bashkisë), gjithashtu është një organ që zgjidhet drejtpërdrejtë nga populli, me votim të përgjithshëm e të fshehtë (neni 109.2 & 3 i KShq).

Njësitë vendore bazë, të pajisura secila me një sferë të konsiderueshme autonomie dhe relativisht të shumta në numër, përballen me një varg problemesh që kanë të bëjnë me **bashkërendimin** dhe **kontrollin**. Për të realizuar bashkërendimin, në nivel kushtetues ngrihet një nivel tjetër i qeverisjes vendore – **qarku**, i cili përcaktohet si njësia ku ndërtohen dhe zbatohen politikat rajonale (neni 110 i KShq). Qarku paraqitet si njësi e përbërë dhe mund të formohet nga disa njësi bazë të kësaj qeverisjeje, të cilat lidhen midis tyre për shkak të përqasjes tradicionale, ekonomike, sociale, si dhe për shkak të interesave të përbashkëta që kanë. Kushtetutëbërësi shqiptar i vendos të tria njësitë e qeverisjes vendore në të njëjtën pozitë juridiko-kushtetuese. Nga ana tjetër, **qarku** shërben edhe si një urë lidhëse ku harmonizohen politikat rajonale me ato shtetërore (neni 110.2 i KShq). Këshilli i Ministrave (KMShq) cakton prefektin, si përfaqësues të tij në çdo qark (neni 114 i KShq). Në kuadrin e detyrës që ka për të bashkërenduar të gjithë veprimtarinë dhe funksionimin e komunave dhe bashkive që formojë territorin e tij, **Këshilli i qarkut** ka të drejtë të nxjerrë urdhëresa dhe vendime me fuqi detyruese të përgjithshme, për të gjithë qarkun (neni 110.4 i KShq). Por kjo nuk do të thotë se dy njësitë bazë të qeverisjes vendore vihen në varësinë hierarkike të tij. Organet qeverisëse të qarqeve nuk gëzojnë kurrfarë pozite superiore mbi ato të komunave e bashkive. Neni 113 i KShq i vë në plan të barabartë funksionet e këshillave komunalë, bashkiakë dhe të qarkut. Ky nen, pra, nuk i vendos ata në kurrfarë hierarkie midis tyre. Në praktikën e deritanishme, organet e qarqeve e kanë pasur të vështirë të gjejnë veten midis kompetencave që ushtrojnë organet e njësive të tjera të qeverisjes vendore. Vënia në jetë e KShq, me sa duket, nuk ka qenë e mjaftueshme në fushën e qarqeve. Sidoqoftë, në tri nivelet e pushtetit, mëvetësia kushtetuese e njësive të qeverisjes vendore nuk është vetëm një mëvetësi administrative. Ajo paraqitet si një **autonomi politike**, **normative** dhe **financiare**.

[110] Ligji nr. 8652, dt. 31.07.2000, "Për organizimin dhe funskionimin e Qeverisjes Vendore". *Fletore Zyrtare* nr. 25 (2000). Aktualisht në fuqi është **Ligji nr. 139/2015 për vetëqverisjen vendore**, miratuar më datën 17.12.2015. *Fletore Zyrtare* nr. 249 (2015).

Nga pikëpamja **politiko-administrative**, organet e njësive vendore janë të pavarura në ushtrimin e funksioneve të tyre. Të zgjedhura drejtpërdrejtë nga populli, ose jo drejtpërdrejtë, ato nuk kanë kurrfarë vartësie me karakter politik nga ndonjë organ tjetër shtetëror. Prefekti si përfaqësues i KMShq në çdo qark, ruan karakter bashkërendues me organet vendore dhe jo karakter epror. Kompetencat e prefektit përcaktohen me ligj (neni 114 i KShq). Në bazë të ligjit të aplikueshëm për prefektin e qarkut, ky i fundit mbetet një organ i ngarkuar kryesisht me kompetenca kontrolli ndaj qeverisjes vendore.[111] Sipas legjislacionit në fjalë, sanksionohet kontrolli shumë i gjerë **a priori** i autoriteteve normative të organeve vendore. Fakti që **KShq** nuk ka autorizuar asnjë organ me kontrollin e akteve të qeverisjes vendore, e bën të detyrueshëm këtë kompetencë të perfektit. **KShq** ka vënë **Gjykatën Kushtetuese** (GJKShq) si organ të vetëm që gjykon lidhur me pajtueshmërinë e akteve normative të qeverisjes vendore me **KShq** dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Ajo vendos gjithashtu edhe për mosmarrëveshjet e kompetencës midis pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore (neni 131 nën "c" dhe"ç*"* i **KShq**). Kompetenca e prefektit ndaj akteve të miratuara nga organet e pushtetit vendor shtrihet deri në pezullimin e përkohshëm të akteve, nëse konstaton paligjshmëri. Kjo nuk është konsideruar antikushtetuese nga **GJKShq**. Fjalën përfundimtare, megjithatë, ngelet në gjyqësorin e rregullt: vetëm gjykata mbetet organi kompetent që mund të shfuqizoj një akt të dalë nga pushteti vendor.

Në lidhje me fakti që **KMShq**, me nenin 115 të **KShq** autorizohet që të shpërndajë ose të shkarkoj një organ të zgjedhur drejtpërdrejtë të njësisë vendore, vlen të theksohet se një përcaktim i tillë kushtetues nuk prek pavarësinë politike të tyre. Këtu kushtetutëbërësi shqiptar ka përcaktuar dy garancione të rëndësishme. Në radhë të parë, ajo ka vendosur shprehimisht se shpërndarja ose shkarkimi i organit vendor mund të ndodhë vetëm në rastet kur ka shkelje të rënda të **KShq** ose të ligjeve nga këto organe. Në radhë të dytë, **KShq** ka parashikuar gardianin e vet si organin garantues, që kontrollon kushtetutshmërinë e shkarkimit ose të shpërndarjes së organit vendor. Ajo i jep mundësinë organit të shkarkuar ose të shpërndarë të ankohet pranë **GJKShq** brenda 15 ditëve. Paraqitja ankesës, me automatizëm pezullon vendimin e **KMShq** (neni 115.2 i KShq). **KMShq** nuk mund të ketë kompetenca pozitive, me kuptim të drejtën e zëvendësimit të organeve të shpërndara ose të shkarkuara prej tij. KShq ka parashikuar se, në rastin e mosushtrimit të së drejtës së ankimit brenda afatit të përcaktuar kushtetues, ose në rastin e lënies në fuqi të vendimit të **KMShq** nga **GJKShq**, Presidenti i Republikës cakton datën e zgjedhjeve në njësinë vendore përkatëse (neni 115.3 i **KShq**).

Autonomia normative shprehet në faktin se organet e të gjitha njësive të qeverisjes vendore nxjerrin **vendime**, **urdhra** dhe **urdhëresa**. Të drejtat dhe funksionet e njësive janë të rregulluara më hollësisht nga ligji. Karakteri territorial përbën edhe aspektin më thelbësor të tyre. Kjo kërkon që aktet e njësive të kenë fuqi detyruese për të gjitha subjektet që jetojnë e veprojnë brenda njësisë territoriale që përfaqëson organi përkatës. Këtu përfshihen aktet vendore:

- urdhëresat dhe vendimet që nxjerrë këshillit të qarkut, të cilat kanë fuqi detyruese të përgjithshme për qarkun (neni 110.4 i **KShq**);
- rregulloret e organizimit dhe të funksionimit që nxjerrin këshillat komunalë, bashkiakë dhe këshillat e qarkut, që kanë të bëjnë me sa vijon: çështjet vendore brenda juridiksionit të tyre; të drejtat e pronës, administrimin në mënyrë të pavarur të të ardhurave të krijuara, si dhe të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë ekonomike; të drejtën e mbledhjes dhe shpenzimit të të ardhurave që janë të domosdoshme për ushtrimin e funksioneve të tyre; të drejtën e vendosjes, në përputhje me ligjin, të taksave vendore, si dhe nivelin e tyre; caktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e tyre në pajtim me ligjin; krijimin e simboleve të qeverisjes vendore, si dhe titujt vendorë të nderit; dhe, së fundi, ndërmarrja e nismave për çështje vendore përpara organeve të caktuara me ligj (neni 113.1 i **KShq**);

[111] Neni 3 (Misioni): "Misioni i prefektit të qarkut është përmbushja e detyrimeve për të garantuar zbatimin e programit politik të Këshillit të Ministrave, në nivel qarku". Ligji nr. 107/2016, dt. 27.10.2016 "PËR PREFEKTIN E QARKUT". Fletore Zyrtare 217 (2016).

- urdhrat, urdhëresat dhe vendimet që nxjerrin organet e njësive të qeverisjes vendore (neni 113.2 i **KShq**).

Përveç faktit në një territor të kufizuar, karakteristikë e këtyre akteve është se, mbi atë territor, ato kanë forcën e ligjit. Në të njëjtën kohë, këto akte kanë detyrim që të jenë në pajtim të plotë me ligjet, të cilat përcaktojnë parimet dhe procedurat për nxjerrjen e tyre. Pra, në përgjithësi, aktet e qeverisjes vendore janë të varura drejtpërdrejt nga ligji dhe jo nga aktet normative të **KMShq** apo të organeve të tjera qendrore. Duhet theksuar se, kjo **autonomi normative** gjen vend edhe në rastin e zbatimit të kompetencave që iu delegohen njësive të qeverisjes vendore (neni 112.1 i **KShq**).

Autonomia financiare është një nga aspektet më të rëndësishme të autonomisë vendore, por njëkohësisht edhe një nga aspektet më problematike e më delikate. Ajo përbën një garanci, jo vetëm për realizimin e asaj vetë, por edhe për arritjen e autonomisë politike, normative dhe administrative. Njësitë e qeverisjes vendore janë persona juridikë dhe kanë bugjet të pavarur (neni 111 i KShq). Njësitë vendore gjithmonë përpiqen të realizojnë këtë autonomi sa më shumë, por që paraqitet si diçka e vështirë.

11.2.4. Ushtrimi vetëqeverisjes nëpërmjet organeve të zgjedhura

Parimi i vetëqeverisjes vendore, i proklamuar në nenin 108 të **KShq**, ushtrohet nëpërmjet **organeve përfaqësuese vendore** dhe **referendumeve vendore** (neni 108.4 i **KShq**). Si një kushtetutë e re, **KShq** ka mundur të vjelë përvojat më të përparuara kushtetuese si dhe ka zbatuar kushtet e përcaktuara me **KEVL**, duke vendosur shprehimisht si kërkesë kushtetuese, votimin e përgjithshëm, si për organet përfaqësuese vendore (këshillat përkatës) edhe për organet ekzekutive të tyre. Krahas parimeve të përgjithshme të zgjedhjeve që afirmohen që në pjesën e parë të KShq, në nenin 1.3., që thotë se "Qeverisja bazohet në sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike", ajo sanksionon shprehimisht zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejtë dhe me votim të fshehtë edhe për organet vendore, duke mos i lënë kurrfarë lirie ligjvënësit për të ndryshuar këto parime. Këtu, megjithatë, bëhet një dallim në **KShq** sa i përket këshillave të qarqeve: edhe ata konsiderohen të zgjedhshëm por jo me votim të drejtpërdrejtë. Ata mund të konsiderohen si organe të zgjedhura më votim të tërthortë, përderisa anëtarët e tyre janë zgjedhur më parë nga qytetarët, si anëtarë të këshillave komunalë e bashkiakë. Çdo zgjedhës e ka të qartë se, kur voton për të zgjedhur drejtpërdrejtë këshilltarët komunalë e bashkiakë, ka votuar njëkohësisht, zgjedhjen e mundshme të anëtarëve të këshillit të qarkut.

Edhe në interpretim të **KShq** është vështirë që zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të konsiderohen si zgjedhje të thjeshta administrative. Ky përfundim rrjedh nga fakti se autonomia që iu njihet bashkësive vendore dhe roli që ato kanë në përcaktimin e politikave rajonale, por edhe nga fakti i njëjtësisë së sistemit zgjedhor shqiptar. Sipas legjislacionit shqiptar, zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore vihen në një plan me zgjedhjet për organet e qeverisjes qendrore. Kjo zgjidhje arsyetohet me faktin se, së pari, pasi zgjedhësi merr pjesë në to, konsiderohet i tillë si anëtar i trupit politik të qytetarëve dhe jo vetëm thjeshtë si një individ i njësisë vendore ku banon. Së dyti, duke arsyetuar nivelet e reja të qeverisjes, në të cilat është vendosur sot pushteti vendor, mund të themi se edhe zgjedhjet vendore janë të lidhura me ushtrimin e sovranitetit të popullit, pavarësisht se jo në mënyrë të drejtpërdrejtë. Së treti, këto zgjedhje zhvillohen në bazë të kodit zgjedhor, njëjtë si në Kosovë dhe gjetiu, dhe sigurojnë një përbërje pluraliste të organeve të pushtetit vendor. Kjo e fundit, është një ndër karakteristikat më të spikatura të demokratizimit të qeverisjes vendore, i cili bëhet i mundur pasi pluraliteti i organeve vendore nuk ka asnjë lidhje dhe nuk kushtëzohet aspak nga pluraliteti dhe karakteri politik i organeve qendrore të qeverisjes. Në **KShq** sanksionohet në mënyrë të rreptë edhe periodiciteti i zgjedhjeve vendore, duke vendosur afate të përcaktuara qartë. Kjo do të thotë se ligjvënësi në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk mund të zgjasë mandatet e organeve të zgjedhura vendore.

Referendumi është mjeti që iu jep mundësi shtetasve të ushtrojnë drejtpërdrejtë demokracinë në kuadrin vendor dhe i lejon ata të marrin vendime politike me interes për komunitetin vendor. I tillë është stipullimi kushtetues, ta zëmë, sipas të cilit kufijtë e ndarjeve administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore nuk mund të ndryshohen, pa u marrë më parë mendimi i popullsisë që banon në to. Ngushtësisht e lidhur me referendumin është edhe e drejta e qytetarit për të ndjekë mbledhjet e organeve përfaqësuese vendore, e drejtë që buron drejtpërdrejtë nga neni 23 i **KShq** (e drejta për t'u informuar). Ngjashëm me këtë është e drejta për të paraqitur kërkesa e peticione, të kërkoj nga organet vendore shërbime kompetente dhe më kulturë demokratike etj. Nga ana e tyre, organet e qeverisjes vendore kanë detyrë të informojnë elektoratin, për mënyrën se si i kanë kryer funksionet.

11.2.5. Qeverisja vendore në praktikën e GJKShq

KShq i ka njohur një rol mjaft të rëndësishëm GJKShq për të kontrolluar e garantuar vetëqeverisjen vendore. Sikundër u tha më sipër, gardiani i kushtetutshmërisë në Shqipëri është organi kompetent që gjykon për pajtueshmërinë e akteve vendore me KShq dhe me marrëveshjet ndërkombëtare. Kjo mund të realizohet përmes vënies në lëvizje të GJKShq jo vetëm nga organet e qeverisjes vendore, por edhe nga shoqata të krijuara nga këto organe (neni 134.1 nën "e" dhe "f" i KShq). Sistemi monist i përzgjedhur nga kushtëtutbërësi shqiptar ka bërë të mundur që **GJKShq** në gjykimet e saj të merr parasysh edhe KEVL. Duke interpretuar parimet e sanksionuara në **KShq** dhe ato në **KEVL**, GJKShq i ka shërbyer kuptimit të drejtë në praktikë të parimeve të dekoncentrimit, decentralizimit dhe qeverisjes vendore.

Organet vendore janë paraqitur si subjekte që kanë vënë në lëvizje **GJKShq**, jo vetëm drejtpërdrejt në bazë të nenit 134 (nën "e") të KShq, por edhe përmes organizatave të tyre në bazë të pikës "f" të nenit të njëjtë. Të tilla kanë qenë rastet, ta zëmë, që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë e një akti qendror normativ me **KShq** (vendimi i **KMShq** i datës 5 maj 2000, "Për Kontrollin financiar"), ku **GJKShq** u vu në lëvizje nga shoqata e kryetarëve të bashkive. Në këtë rast, **GJKShq** konsideroj se është në përputhje të plotë me KEVL kontrolli financiar qendror që ushtrohet mbi organet e pushtetit vendor, i cili, si një nga llojet e kontrollit administrativ, i mbron subjektet vendore nga dëmtimet dhe humbjet financiare. Në të njëjtën kohë, **GJKShq** ka rikonfirmuar faktin e përcaktuar në vendimin e sipërcekur të KMShq se, kontrolli financiar nga qendra kufizohet vetëm në atë pjesë të buxhetit të shtetit që i është transferuar pushtetit vendor nga pushteti qendror dhe vetëm për probleme të veçanta. Këtu, pra, përjashtohet ndërhyrja në kontrollin e pjesës së buxhetit të pavarur. U mor vesh, sipas legjislacionit shqiptar, njëjtë si në vendet tjera, ligjshmëria e përdorimit të burimeve financiare kontrollohet nga **Kontrolli i Lartë i Shtetit** (KLSH). Në vendimin si më sipër, GJKShq më tej ka arsyetuar se, organet e kontrollit marrin vendime për ndalimin e përkohshëm të veprimeve të organeve vendore që bien ndesh me ligjet e shtetit ose cenojnë interesat ekonomike të tij, deri në shqyrtimin përfundimtar nga organet kompetente, gjë që nuk shkel pavarësinë e pushtetit vendor.

Në një rast tjetër, **GJKShq** e ka konsideruar si shkelje të autonomisë së pushtetit vendor faktin që ngritja dhe funksionimi i **Këshillit të Rregullimit të Territorit** (KRRT) pranë administratës vendore të miratohet nga ministri përkatës. **GJKShq** ka konsideruar si antikushtetuese edhe nenet e ligjit "Për urbanistikën", që i jepnin të drejtë ministrit përkatës të emëronte dhe të shkarkonte personelin e organeve të administratës vendore për urbanistikën. Gardiani ka kufizuar njohjen e kompetencës së pushtetit qendror për shkarkimin e funksionarëve të mësipërm nga ministri, vetëm në raste të veçanta dhe të motivuara. Me këtë vendim është konfirmuar e drejta që njësitë e qeverisjes vendore të gëzojnë të drejtën për të krijuar struktura administrative për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tyre. Vendimi, përtej kësaj, ka ndihmuar dhe ndihmon në ushtrimin real të asaj që e quajmë vetëqeverisje vendore.

Në jurisprudencën e saj, GJKShq ka qëndruar besnike ndaj **parimit të ligjshmërisë** së akteve të qeverisjes vendore, i cili kërkon që aktet e miratuara nga organet e vetëqeverisjes të jenë në përputhje

me ligjin. Këtë detyrim e kanë edhe aktet nënligjore që miratohen nga organet qendrore. Prandaj, në rast kundërshtie, nuk janë këto të fundit që vendosin, por gjyqësori i rregullt. **GJKShq**, megjithatë, ka mbrojtur të drejtën e prefektit për të pezulluar një akt të paligjshëm të organeve të qeverisjes vendore dhe nuk e ka quajtur këtë një përplasje të kompetencave midis organeve e as cenim të parimeve kushtetuese. Këtë qëndrim ajo e ka mbështetur në arsyetimin se decentralizimi nuk presupozon kompetenca absolute të organeve të qeverisjes vendore dhe as shkëputje të çdo lloj vartësie me pushtetin qendror. GJKShq në këtë mënyrë nuk ka mohuar kontrollin hierarkik administrativ mbi veprimtarinë e organeve vendore, por të kufizuar deri në pezullimin e zbatimit të këtyre akteve.

Për të ruajtur të sferën e pushtetit qendror e vendor, **GJKShq** ka interpretuar **KShq**, duke konsideruar të papajtueshëm funksionin e deputetit me atë të kryetarit të bashkisë, apo të komunës. Në vendimin e saj, vendimi nr. 37 i datës 23 qershor 2000, ajo ka theksuar se kryetarët e komunave nuk kanë të drejtë të kandidojnë e të zgjidhen deputet dhe anasjelltas.

11.2.6. Referendumet vendore

Referendumi në **Shqipëri** mund të jetë i përgjithshëm dhe vendor. Organizimi i referendumit të përgjithshëm mund të kryhet kur kërkohet prej më shumë se 50000 shtetasve me të drejtë vote, për shfuqizimin e një ligji si dhe për çështjet e një rëndësie të veçantë. Referendumi i përgjithshëm parashikohet edhe për ndryshimin e KShq, rast të cilin e quajmë **referendum kushtetues** (nenet 150-152 dhe 177 të KShq). Në **referendum vendor**, ndërkaq, mund të dalin çështjet e ndryshme të qeverisjes, në bashkinë apo komunën përkatëse, si dhe në shkallë rajonale pranë qarkut. KShq kërkon shprehimisht që çështja e ndryshimit të kufijve dhe e ndarjeve territorialo-administrative të njësive përkatëse, të vendoset pasi është marrë paraprakisht mendimi i popullsisë që banon në to. Kur ajo thekson në nenin 108.2 se kufijtë e ndarjeve administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore nuk mund të ndryshohen pa u marrë më parë mendimi i popullsisë që banon në to, atëherë nënkuptohet se një gjë e tillë mund të realizohet vetëm me referendum, sa kohë që nuk është përcaktuar kuptimi i një **plebishiti popullor** dhe **dallimi i tij me referendumin**. Procedurat për zhvillimin e **referendumit vendor** dhe hollësi të mëtejshme rreth tij, parashikohen nga **Kodi Zgjedhor** (2008, me ndryshimet e plotësimet e mëvonshme) (**KZShq**). Në këtë rast, vendimi përfundimtar i përket Kuvendit të Shqipërisë, i cili miraton me ligj ndarjen administrativo-territoriale të Shqipërisë, me të cilin materializohet vendimi i referendumit për kufijtë e ndarjes së re administrativo-territoriale. Ky lloj i referendumit organizohet sipas rregullave të KZShq.

Edhe referendumi vendor, në parim, i nënshtrohet rregullave të përgjithshme që **KZShq** ka parashikuar për referendumet në përgjithësi. Si një lloj i veçantë i referendumeve, megjithatë, ai ka disa veçori të tjera të dallueshme. **KZShq** ka vendosur dy kategori të referendumeve vendore: **referendumin në njësitë bazë të qeverisjes vendore** dhe **referendumin në nivel qarku**. Nisma për referendum vendor në nivel të njësive bazë, i takon 10 % të zgjedhësve të regjistruar në listat e zgjedhësve të komunës a bashkisë. Kjo nismë mund të merret edhe nga 20000 zgjedhës, banorë të njësive. Ai mund të kryhet për çështje të rëndësishme të qeverisjes vendore në lidhje me bashkinë ose komunën përkatëse.

Referendumi në kuadrin e qarkut, mund të organizohet për probleme e propozime që lidhen me të. Nismën mund ta marrin një numër këshillash bashkiakë ose komunalë që përfaqësojnë jo më pak se një të tretën e popullsisë së qarkut. Kërkesa për referendum i paraqitet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i cili, brenda një afati të caktuar nga data e paraqitjes, vendos pranimin ose mospranimin e saj mbi bazën e rregullsisë së dokumentacionit të paraqitur. **KZShq** parashikon edhe rregulla të tjera, mbi bazën e të cilat organizohet referendumi.

11.3. Maqedonia e Veriut

11.3.1. Historiku

Për shtjellimet tona për **Maqedoninë e Veriut**, përveç literaturës së përdorur për shtjellimet e vetëqeverisjes lokale në vendet e ish-Jugosllavisë, kemi përdorur edhe burimet e autorëve për sa vijon: **Zdravko Zlokapa** dhe **Dushan Damjanoviq**,[112]**Svetomir Shkariq**,[113] **Gordana Siljanovska – Davkova, Vladimir Mitkov, Tanja Karakamisheva – Jovanovska, Aleksandar Spasenovski, Marko Krtopica**,[114] si dhe disa botime të autorëve të tjerë.[115] Sa i përket aspektit pozitivo juridik, shtjellimet bazohen në zgjidhjet kushtetuese dhe ligjore në fuqi në kohën e shkrimit të këtyre rreshtave (maj 2023). Në këtë kuptim, shënojmë se, organizimi dhe ndarja territoriale e njësive të vetëqeverisjes lokale në Maqedoninë e Veriut adresohet në fillim të vitet '60 të shekullit të kaluar, njëjtë si gjetiu në ish-Jugosllavi. Më 1962, territori i kësaj republike jugosllave ndahet në komuna, si një njësi themelore administrativo – territoriale. Krejt vendi ka pasur 34 komuna. Ky sistem, sistemi komunal i vetëqeverisjes lokale, është zbatuar deri më 1991, afërsisht njëjtë si në ish-republikat jugosllave. Maqedonia e Veriut neglet shtet unitar, siç e kemi thënë më herët, me një decentralizim të fuqishëm në nivel të vetëqeverisjes lokale, pa pasur asnjë nivel tjetër të ndërmjetëm të pushtetit (regjione). As **MO**, e cila ndaloj konfliktin e armatosur mes shqiptarëve të prirë nga **U**ÇK-ja dhe forcave të rendit të këtij vendi, nuk ka ndryshuar asgjë në formën e shtetit, pos që i ka dhënë një shtytës të fuqishëm procesit të decentralizimit në këtë vend. Në literaturë, decentralizmi dhe **MO** janë konsideruar si elementë të domosdoshëm për rrugën euro-atlantike të **Maqedonisë së Veriut**, në fakt si një kusht thelbësor për integrimin e këtij vendi në strukturat euro-atlantike.[116] Qysh në vitin 1999, **Qeveria e Maqedonisë Veriore** (QeMVe) pat vënë në qendër të vëmendjes decentralizimin, duke bërë atë një agjendë urgjent. Kjo u bë e tillë, megjithatë, vetëm pas lidhjes së MO, e cila u reflektua në një masë të konsiderueshme në amendamentet XVI dhe XVII (2001) në KMVe. Me këto akte juridike decentralizmit në bazë etnike iu dha një frymë e re nga e cila përfitoj kombi shqiptar që jeton në trojet e veta në këtë republikë, sepse u futën inovacione institucionale në favor të ruajtjes së kulturës, identitetit dhe traditave të tyre.

11.3.2. Kuadri juridik

Si një kurorë e decentralizimit lokal evropian, **KEVL** është ratifikuar në Maqedoninë e Veriut më 6 qershor 1997 dhe ka hyrë në fuqi më 1 tetor të po atij viti. Sipas nenit 118 të **KMVe**, përcaktohet që, **inter alia**, "[...] Marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare në pajtim me kushtetutën janë pjesë integrale e rendit juridik dhe nuk mund të ndryshohen me ligj", dispozitë kjo e ngjashme me nenin 19.1 të KKos. Për pasojë, KEVL konsiderohet si pjesë përbërëse e rendit juridik, me fuqi më të lartë juridike se çdo ligj në fuqi në këtë vend, përfshirë ligjet që normojnë drejtpërdrejtë vetëqeverisjes lokale. Ngjashëm me vendet tjera përreth Kosovës, në **KMVe** ekzistojnë dispozita specifike që rregullojnë sistemin e vetëqeverisjen lokale (nenet 114-117 të KMVe). Ky sistem konsiderohet si një vlerë themelore e rendit kushtetues maqedonaso-verior (neni 8 i KMVe). Gjithashtu, KMVe garanton të drejtën për vetëqeverisje lokale për të gjithë qytetarët dhe përcakton komunën si një themelore të saj (neni 114. 1 7 2 i **KMVe**). Përveç

---

112 Zdravko Zlokapa & Dušan Damjanović (eds.), *Modeli organizacije lokalne samouprave: Slovenija, Hrvatska, Bosna i Hercegovina, Makedonija i Srbija* (PALGO centar: Beograd, 2008).

113 Svetomir Škarić, *Ustavno pravo* (Kultura: Skopje, 2009) (në gjuhën maqedone, alfabeti cirilik).

114 Gordana Siljanovska – Davkova, Vladimir Mitkov, Tanja Karakamisheva – Jovanovska, Aleksandar Spasenovski, Marko Krtopica, *Lokalna samouprava* (Konrad Adenauer Shtiftung: Skopje 2020) (në gjuhën maqedone, alfabeti cirilik).

115 Tjaša Ivanc*, Lokalna samouprava u Makedoniji. Lex Localis – Journal of Local Self-Government* Vol. 5 No. 2 (Summer 2007), fq. 141-167.

116 Cf. më shumë në Gordana Siljanovska-Davkova, "Legal and Institutional Framework of Local Self-Governement in the Republic of Macedonia". *LEX LOCALIS - JOURNAL OF LOCAL SELF-GOVERNMENT* Vol. 7, No. 2 (April 2009), fq. 107 – 127.

këtyre garancioneve, nenet 114-117 të KMVe përcakton edhe disa standard e parime të tjera mbi të cilat ndërtohet sistemi maqedonaso-verior i vetëqeverisjes lokale, karakteristikat e të cilit janë për sa vijon:

- në komuna mund të formohet forma të vetëqeverisjes lokale;
- komunave u garantohet pavarësia në ushtrimin e kompetencave të tyre, të përcaktuara me KMVe dhe ligj;
- komunave u garantohen burimet financiare si dhe financimi shtetëror;
- promovohet demokracia lokale e drejtpërdrejtë dhe përfaqësuese;
- definimi i qytetit të Shkupit si një njësi e ndarë e vetëqeverisjes lokale, organizimi i së cilës rregullohet me ligj të veçantë.

Vlen të theksohet se në periudhën 1991-1995 ka ekzistuar një sistem kalimtar i vetëqeverisjes lokale, përkatësisht një sistem i përkohshëm nga koha e prishjes së sistemit komunal të vetëqeverisjes lokale në këtë vend që ndodhi më 1988/1989. Në këtë kohë nis koha decentralizimit gradual të pushtetit shtetëror dhe bartjes së tij në njësi të vetëqeverisjes lokale. Në këtë periudhë, megjithatë, akoma vazhdon kontrolli i rreptë financiar dhe tjetër i pushtetit qendror. Në këtë periudhë më shumë bëhet fjalë për **dekoncentrim** se sa për ndonjë vetëqeverisje demokratike, përkundër që në vitin 1995 vjen deri te nxjerrja e ligjit të parë mbi vetëqeverisjen. Kjo gjendje, pra, ka ekzistuar në një kohë që në fuqi ka qenë KMVe që sot është në fuqi me amendamentimet e mëpastajme.[117]

Në pajtim me amendamentet XVI dhe XVII (2001) në **KMVe**, që ishin pjesë e zotimit nga MO, në njësitë e vetëqeverisjes lokale, qytetarët drejtpërdrejtë dhe përmes përfaqësuesve të tyre vendosin mbi çështjet e rëndësisë lokale, në veçanti në fushat e shërbimeve publike, planifikimit urban dhe rural, mbrojtjes së ambientit, zhvillimit ekonomik lokal, financat lokale, veprimtaritë e mirëmbajtjes komunale, kulturën, sportin, edukimin, kujdesin shëndetësor dhe në fushat tjera të përcaktuara me ligj. Kjo e bënte të qartë karakterin demokratik të vetëqeverisjes lokale dhe i jepte një jetë të re decentralizimit mbi baza etnike, në të cilin shqiptarët përfitonin shumë. Më 2002 është nxjerrë **Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale**, i cili është aktualisht në fuqi dhe që ka krijuar bazat për nisjen e procesit të decentralizimit të mirëfilltë. Me këtë ligj vihen në jetë zotimet kushtetuese nga dy amenadamentet e sipërcekura. Përveç këtij ligji, dymbëdhjetë ligje të tjera kanë rrumbullakuar sistemin kushtetues të vetëqeverisjes lokale në këtë vend, siç janë: **Ligji për Decentralizimin Fiskal**, **Ligji për Kufijtë e Komunave, Ligji për Riorganizim Territorial**, **Ligji për Zgjedhjet lokale**, **Ligji për Pjesëmarrje të Qytetarëve në Procesin e Vendimmarrjes** dhe kështu me radhë. Në të njëjtën kohë janë miratuar ose janë amendamentuar më shumë se tetëdhjetë ligje të tjera sektoriale, për bartje të kompetencave ashtu siç përcaktohet me nenin 22 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, i cili përcakton listën e kompetencave të komunave, ose për shkak se përmbajnë dispozita mbi vetëqeverisjen lokale. Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale është nxjerrë me dy të tretat e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Maqedonisë (KuMV), në frymën e amendamentit XVII në KMVe, brenda së cilës shumicë duhet të jenë edhe votat e shumicës absolute të përfaqësuesve që i përkasin komuniteteve joshumicë në Maqedoninë e Veriut. Ky **sistem i dyfishtë**, i njohur si **parimi Badinter**, është dashur edhe për miratimin e **Ligjit për Financat Lokale**, **Ligjin për Zgjedhjet Lokale**, **Ligjin për Kufijtë e Komunave**, **Ligjin për Qytetin e Shkupit**, si dhe për miratimin e ligjeve që drejtpërdrejtë prekin në kulturën, përdorimin e gjuhës, edukimin, dokumentet personale dhe përdorimin e simboleve.

11.3.3. Pushteti lokal dhe autonomia e tij

Maqedonia e Veriut ka sistemin njëshkallësh të vetëqeverisjes lokale, me komunat si njësi lokale themelore. Në vitin 2004, **Ligji mbi Organizimin Territorial** ka ulur numrin e komunave nga 124 në 84, kurse qyteti i Shkupit u njoh si njësi specifike vetëqeverisëse. Në rastin e njësisë vetëqeverisëse të

[117] Cf. më shumë për këtë në Tjaša Ivanc*, Lokalna samouprava u Makedoniji*, fq. 141-151.

Shkupit, ky ligj përcaktoi se si do të ketë dhjetë (10) komuna, për dallim nga shtatë (7) sa kishte pësuar në të kaluarën, brenda vetë qytetit të Shkupit dhe shtoi kufijtë e tij për të përfshirë edhe disa qendra rurale banimi. Për rrjedhojë, komuniteti shqiptar tani përbën (20%) të popullsisë së qytetit, duke e bërë Shkupin qytet dygjuhësor. Kjo reformë territoriale ka qenë pjesë e projektit të decentralizimit dhe u bë për dy arsye:

- së pari, për shkak të nevojës për të harmonizuar organizimin e komunave, duke eliminuar komunat e vogla që nuk ishin treguar të qëndrueshme; përkundër reformës, struktura e komunave prapë ngeli e ndryshme dhe me shumë komuna të vogla në numër: 16 syresh kishin popullsinë më të vogël se 5.000 banorë dhe 32 të tjera një popullsi më të vogël se 10.000; në fund, vetëm 22 komuna ngelën me popullsi më të madhe se 30.000;
- së dyti, për shkak të korrigjimit të shpërputhjeve mes popullsisë shumicë maqedonase dhe pakicës shqiptare nëpër disa komuna: kështu, në komunën e Kërçovës, shqiptarët nga 20% në 50%, kur u bë bashkimi i saj me komunat fqinje që kishin shumicë shqiptare në popullsitë e tyre.

Pjesa e decentralizimit që kishte të bënte me shqiptarët, ishte rrjedhojë e drejtpërdrejtë e MO, gjë që u kritikua fuqishëm nga konstitucionalistët maqedonaso-verior, që e panë atë si një koncesion ndaj pakicës shqiptare dhe si një **gerrymandering** (prishje e kufijve zgjedhor me qëllim të favorizimit të elektrotatit të përcaktuar që më parë, bazuar në afinitete politike, racorre, etnike, gjuhësore, fetare dhe cilësi të tjera).[118] Decentralizimi u vendos në nivel qendror dhe pa asnjë konsultim me popullsinë lokale maqedonase, sepse dihej a priori mendimi i tyre: ata kurrë nuk do të lëshonin pe për një decentralizim të tillë që fuqizonte identitetin dhe rolin e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut. Një seri e referendumeve, me tridhjetë (30) referendume lokale qenë të suksesshme, dhe një referendum nacional që nuk pati sukses, u refuzua ky decentralizim. Në fund, ai u miratua në Kuvendin e Maqedonisë dhe u bë ligj.[119] Raporti i forcave ishte në favor të shqiptarëve të këtij vendi, sepse konflikti i ashpër i armatosur sapo kishte marrë fund dhe çdokush dëshironte qetësi dhe paqe.

Në vijim si më sipër, pushteti qendror ka autorizime për të përcaktuar parimet, mënyrat dhe instrumentet juridike për vetëqeverisjen lokale dhe kuadrin e saj juridik. Këto autorizime nënkuptojnë, sipas KMVe dhe ligjit në fuqi, për sa vijon:

- pushteti qendror mund të formoj njësi të reja të vetëqeverisjes lokale dhe të ndryshoj hapësirat dhe numrin e tyre;
- pushteti qendror mund organizoj dhe udhëheq zgjedhjet lokale; dhe
- pushteti qendror mund të mbikëqyr operimin e organeve komunale.

Kjo nuk do të thotë se autoritetet lokale janë të zhveshura nga autorizimet dhe kompetencat konkrete në çështjet lokale. Në këtë kuptim, ato kanë autorizimet dhe kompetencat për sa vijon:

- të kenë territorin dhe emrin, stemën dhe flamurin;
- të kenë rregullat e tyre, në mesin e të cilave statuti është më i larti për nga fuqia juridike brenda njësisë së vetëqeverisjes;
- të kenë punët vetjake dhe punët e deleguara;
- të kenë resurset vetjake dhe resurset e tjera të financimit të punëve të tyre;
- të kenë trupat e tyre të zgjedhura drejtpërdrejtë nga qytetarët;
- të kenë banorët që janë shtetas të Maqedonisë së Veriut, me vendbanim të përhershëm në territorin e komunës.

[118] Natalija Nikolovska & Gordana Siljanovska-Davkova, *Tranzition in Deficiency- from Unitary toward Bi-national State* (Skopje: Magor: Skopje, 2001), fq. 56.

[119] Gordana Siljanovska-Davkova, "Legal and Institutional Framework of Local Self-Governement in the Republic of Macedonia", fq. 110.

11.3.4. E drejta për asociim dhe bashkëpunimi ndërkomunal

Njëjtë sikur në vendet përreth Kosovës, sipas ligjit, komunat mund të formojnë **asociacionet** për qëllim të mbrojtjes dhe përparimit të interesit të përbashkët. Asociacioni, në të cilin janë futur dy të tretat (2/3) të komunave nga tërë territori i Maqedonisë së Veriut, kanë të drejtë për sa vijon:

- të bashkëpunoj me QeMve lidhur me çështjet me rëndësi për komunat në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- të iniciojë miratimin e ligjeve që i referohen përmirësimit të vetëqeverisjes lokale;
- të merr pjesë me propozimet vetjake në procedurën për darftimin e buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pjesën që ka të bëj me alokimin e fondeve për komunat me qëllim të ushtrimit të kompetencave të përcaktuara me ligj; dhe
- të bashkëpunoj me organizatat e ngjashme nga vendet tjera dhe të përfaqësoj Republikën e Maqedonisë së Veriut në organizatat ndërkombëtare të autoriteteve lokale.

Asociacioni formohet, organizohet, funksionon dhe regjistrohet në mënyrën dhe nën kushtet e përcaktuara me ligj. Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale ka promovuar format vullnetare për formim të asociacioneve të komunave.

Sa i përket **bashkëpunimit ndërkomunal**, ekzistojnë forma të ndryshme të tij. Komunat kanë mundësi të bashkëpunojnë mes tyre dhe me njësitë e vetëqeverisjes lokale të vendeve të tjera dhe me organizatat ndërkombëtare të vetëqeverisjes lokale, si dhe mund të jenë anëtarë të organizatave ndërkombëtare të qeverisjeve lokale. Me qëllim të realizmit të interesit të përbashkët dhe kryerjes së detyrave të përbashkëta, komunat maqedonaso-veriore mund të bashkojnë fondet dhe të themelojnë agjenci publike në pajtim me ligjin. Komunat gjithashtu mund të themelojnë trupa të përbashkët administrativë në sferat e caktuara, në bazë të vendimit të miratuar me shumicën e votave të numrit të tërësishëm të anëtarëve të secilit këshill komunal. Në këto raste, lidhet një marrëveshje e shkruar për të definuar komunat që themelojnë trupën e përbashkët administrative.

11.3.5. Kompetencat

Për dallim nga Mali i Zi dhe Kosova, në **Maqedoninë e Veriut** njihen vetëm dy lloje të kompetencave të njësive të vetëqeverisjes lokale: **kompetencat e përcaktuara me ligj** dhe **kompetencat e deleguara. Ligji për Vetëqeverisjen Lokale**, aktualisht në fuqi, ka bërë ndryshime cilësore në raport me zgjidhjet ligjore të vitit 1995: tani është rritur numri i kompetencave që dikur janë ndarë, duke i bërë ato kompetenca thellësisht **vetjake**. Aktualisht, komunat i kanë të garantuara këto kompetenca:

- **planifikimi urban dhe rural** (planifikimi urban dhe lëshimi i dokumentacionit teknik për ndërtim dhe lëshimi i lejeve të ndërtimit; rregullimi dhe mirëmbajtja e tokës ndërtimore);
- **mbrojtja e ambientit, natyrës dhe hapësirës së rregullimit** (masat për mbrojtjen dhe pengimin e ndotjes së ajrit, atmosferës dhe tokës; mbrojtja e natyrës, mbrojtja kundër zhurmës dhe rrezatimit jonizues);
- **zhvillimi ekonomik lokal** (zhvillimi dhe planifikimi lokal, përcaktimi i prioriteteve zhvillimore dhe strukturore; draftimi i politikës lokale ekonomike; mbrojtja për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe ndërmarrësisë në nivel lokal dhe, në këtë kontekst, pjesëmarrja në themelimin dhe zhvillimin e rrjetit të institucioneve dhe agjencive lokale; promovimi i partneritetit);
- **shërbimet e njësisë komunale të shërbimeve** (furnizimi me ujë të pijshëm; furnizimi me ujë për industritë; përpunimit dhe pastrimi i ujërave të zeza; ndriçimi publik; përpunimi dhe trajtimi i vendeve me rrezik për vërshime; mbajtja e higjienës publike; mbledhja, transporti dhe trajtimi i plehrave industrial dhe plehrave të përditshëm komunal; rregullimi dhe organizimi i transportit publik të udhëtarëve; furnizimi me gas dhe ngrohje; mirëmbajtja e varrezave, krematoriumeve dhe ofrimi i shërbimeve të varrimit; ndërtimi, mirëmbajtja, rindërtimi dhe mbrojtja e rrugëve lokale,

rrugicave dhe stabilimenteteve të tjera rrugore; rregullimi i regjimit në trafik; ndërtimi dhe mirëmbajtja e sinjalizimit në rrugë qarkullimi; ndërtimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike për parkim; heqja e makinave të parkuara gabimisht; heqja nga rruga e makinave të dëmtuara dhe përdorimi i parqeve, hapësirave të gjelbra, maleve dhe hapësirave për rekreacion; rregullimi, mirëmbajtja dhe përdorimi i brigjeve të lumenjve në pjesët urbane; caktimi i emrave të rrugëve, shesheve, urave dhe stabiliteteve të tjera infrastrukturore.

- **kultura** (ruajtja e trashëgimisë kulturore, shënimi i ngjarjeve dhe personave me rëndësi për kulturën dhe historinë e komunës);
- **sporti dhe rekreacioni** (zhvillimi i aktiviteteve të përgjithshme sportive dhe aktiviteteve rekreancionale të qytetarëve; organizimi i ngjarjeve sportive; mirëmbajtja dhe ndërtimi i pajisjeve sportive me interes publik për komunën; mbështetja e shoqatave sportive);
- **mirëqenia sociale dhe mbrojtja e fëmijëve** (kopshtet e fëmijëve dhe shtëpitë e pleqve, nga prona, financimi, investimi e deri te mirëmbajtja e tyre; ushtrimi i kujdesit social për personat me të meta; fëmijët pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore; fëmijët me probleme sociale dhe edukative; fëmijët me nevoja të veçanta; fëmijët me familjet me një prind; fëmijët e braktisur; personat e ekspozuar ndaj rrezikut shoqëror; personat me drogë dhe alkool dhe probleme të vartësisë; ngritja e vetëdijes së qytetarëve; gjetja e shtëpisë për prindërit të vënë në rrezik shoqëror; strehimi dhe edukimi parashkollor i fëmijëve);
- **edukimi** (themelimi, financimi dhe administrimi i shkollave fillore dhe të mesme, në bashkëpunim me QeMVe dhe në pajtim me ligjin; organizimi i transportit të studentëve dhe akomodimi i tyre në konvikte);
- **kujdesi shëndetësor** (administrimi me organizatat shëndetësore dhe ndërtesat e kujdesit primar shëndetësor, përmes përfaqësimit të vetëqeverisjes lokale në të gjitha bordet organizatave publike të kujdesit shëndetësor; përmirësimi i shëndetit; aktivitetet preventive; mbrojtja e shëndetit të punëtorëve dhe mbrojtja në punë; mbikëqyrja shëndetësore ndaj ambientit jetësor; kontrolli ndaj sëmundjeve ngjitëse; ndihma ndaj pacientëve me nevoja speciale (shëndeti mendor, abuzimi me fëmijët etj); dhe fusha të tjera të përcaktuara me ligj);
- **kryerja e përgatitjeve dhe ndërmarrja e aktiviteteve për mbrojtjen dhe shpëtimin e qytetarëve dhe të mirave** në territorin e tyre kundër shkatërrimeve nga lufta, fatkeqësitë natyrore dhe të tjera, si dhe kundër pasojave të shkaktuara nga njerëzit në kohë lufte;
- **luftimi kundër zjarrit dhe aktivitetet tjera të zjarrfikësve lokal**;
- **mbikëqyrja e zbatimit të aktiviteteve në kuadër të kompetencave komunale**;
- **aktivitete të tjera të përcaktuara me ligj**.

Në pajtim me **KMVe** (neni 115) dhe Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, një trup i administratës publike mund të **delegojë** kryerjen e disa punëve nga kompetenca e vet në kryetarin e komunës. Në një rast të tillë, fondet nga buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, të parapara për kryerjen e detyrave të deleguara, gjithashtu do të barten te kryetari i komunës. Mënyra e kryerjes së kompetencave të deleguara mund të përshtatet me kushtet dhe kërkesat lokale, gjithnjë duke respektuar standardet e caktuara me ligj.

11.3.6. Organet e pushtetit lokal

Trupat komunale janë si vijon:

- **kuvendi komunës;** dhe
- **kryetari komunës.**

Kuvendi është trup përfaqësues i qytetarëve. Numri i anëtarëve në këshill varet nga numri i banorëve të komunës dhe nuk mund të jetë më i vogël se nëntë (9) (nëse numri banorëve është deri në 5.000) dhe as më i madh se tridhjetë e tre (33) (nëse numri banorëve të komunës kalon 100.000). Përjashtim i vetëm ligjor nga kjo rregull është kuvendi i komunës së qytetit të Shkupit, i cili përbëhet nga dyzetë

e pesë (45) anëtarë. Këshilltarët komunal, anëtarët e kuvendeve komunale, zgjidhen sipas sistemit të votës proporcionale të metodës **D'Hondt**. Çdo qytetar i Maqedonisë së Veriut fiton të drejtën e votës kur të mbush tetëmbëdhjetë (18) vjet. Përveç kësaj, qytetari duhet të ketë vendbanimin e përhershëm në komunën ku ajo/ai voton. Kandidatët dhe qytetarët që përkrahin këshilltarët duhet të jenë shtetas dhe banor permanent në komunën ku janë nominuar këshilltarët. Mandati i këshilltarit zgjat katër (4) vite. Ata përfaqësojnë qytetarët dhe marrin vendime në kuvend sipas bindjeve të tyre. Kuvendi punon në sesione (mbledhje), të cilat i thërret kryesuesi i kuvendit. Sesionet e tij duhet të ndiqen nga shumica e numrit të tërësishëm të këshilltarëve. Kuvendi merr vendime me shumicë votash të këshilltarëve prezent dhe që votojnë, përveç nëse ligji dhe statuti i komunës përcaktojnë ndryshe. Një përjashtim i tillë ka të bëj me statutin, rregullat e procedurës, buxhetin dhe llogarinë përfundimtare, të cilat miratohen me **shumicën e votave** të krejt numrit të këshilltarëve të kuvendit. Sesionet e kuvendit janë të hapura për publikun.

Në kompetencë të **kuvendit të komunës** janë çështjet për sa vijon:

- miratimi i statutit të komunës dhe akteve të tjera komunale;
- miratimi i buxhetit dhe llogarisë përfundimtare të komunës;
- caktimi i madhësisë së burimeve të të hyrave vetjake për financimin e komunës, brenda kuadrit të përcaktuar me ligj;
- themelimi i agjencive publike brenda kompetencave të komunës dhe mbikëqyrja e punës së tyre;
- caktimi i anëtarëve të bordeve menaxhuese të agjencive publike të themeluara nga kuvendi komunal;
- miratimi i programeve të punës dhe programeve të financimit të agjencive publike të themeluara nga komuna;
- miratimi i raportit mbi ekzekutimin e buxhetit dhe të pasqyrave të llogarisë përfundimtare të komunës;
- vendos për dhënien e lejeve për kryerjen e aktiviteteve me interes publik, në pajtim me ligjin;
- miratimi i raportit mbi veprimin dhe pasqyrat vjetore të agjencive publike të themeluara nga komuna;
- disponimi me pronën publike;
- zgjedhja e kryeshefave të njësive regjionale të ministrisë së punëve të brendshme në komunë, në pajtim me ligjin;
- rishikimi dhe miratimi i raportit vjetor mbi sigurinë publike në territorin e komunës, i cili i dërgohet ministrisë së punëve të brendshme dhe prokurorit publik;
- dhënia e rekomandimeve për kryeshefin e njësisë regjionale të punëve të brendshme në sferën e sigurisë publike dhe të trafikut; dhe, së fundit,
- kryen edhe aktivitete të tjera të përcaktuara me ligj.

Kryesuesi i kuvendit komunal zgjidhet nga kuvendi më shumicën e votave të krejt numrit të anëtarëve të tij (këshilltarëve komunal). Ajo/ai thërret sesionet e kuvendit, kujdeset për organizimin dhe punën e kuvendit, nënshkruan rregulloret e miratuara nga këshilli dhe ia paraqet kryetarit të komunës për publik.

Kuvendi komunës **shpërndahet** nëse shumica e numrit të tërësishëm i anëtarëve përkrahë një gjë të tillë, përkatësisht vetëshpërndarjen (inicimi i vetëshpërndarjes). Ai shpërndahet edhe në rrethanat për sa vijon:

- miraton sërish rregulloren e njëjtë, e cila më heret është anuluar ose abroguar me vendim të **Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut** (GJKMVe);
- miraton sërish vendimin e njëjtë, i cili rrezikon sovranitetin dhe integritetin territorial të Maqedonisë së Veriut;

- nuk mblidhet në sesione përgjatë kohës më të gjatë se gjashtë (6) muaj; dhe, së fundi,
- nuk miraton buxhetin dhe pasqyrën vjetore deri më 31 mars të vitit aktual.

Për krijimin e rrethanave si më sipër, kryetari i komunës ka detyrim që të njoftoj ministrinë përkatëse për vetëqeverisje lokale.

Në komuna formohen **komisionet**, që mbulojnë kompetencat e komunave. Ato mund të kenë karakter të **përhershëm** ose **ad hoc**. Statuti rregullon numrin e tyre dhe përgjegjësitë. Kuvendi zgjedh anëtarët e komisioneve. Disa prej tyre mund të jenë dhe janë këshilltarët, të tjerët ekspert në fushat e aktiviteteve të komisionit ku janë zgjedhur. Në komunat në të cilat më shumë së 20% e numrit të tërësishëm të banorëve të komunës, bazuar në regjistrimin e fundit, i takojnë një komuniteti të caktuar, themelohet një **komitet mbi marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve**. Ky komitet përbëhet nga një numër i barabartë i përfaqësuesve të secilit komunitet në komunë. Komiteti merret me çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet mes komuniteteve të përfaqësuara në komunë dhe jep mendime e propozon zgjidhje të çështjeve konkrete. Kuvendi ka për detyrim që të merr në shqyrtim mendimet dhe propozimet në fjalë.

Kryetari i komunës është trup ekzekutiv i komunës. Procedura e caktimit dhe kushtet legale për kryetar komune janë të ngjashme me ato për këshilltarët komunal. Ajo/ai zgjidhet sipas modelit mazhoritar të votimit. Konsiderohet i zgjedhur nëse merr votat shumicë të atyre që kanë votuar, me kusht që në votim kanë dalë një e treta (1/3) e krejt trupës zgjedhore në komunë. Nëse ky nuk është rasti, atëherë organizohet raundi i dytë i zgjedhjeve për dy kandidatët më të votuar në raundin e parë. Fitues shpallet ai që ka fituar shumicën e votave të raundit të tyre të zgjedhjeve.

Kompetencat e **kryetarit të komunës** janë si vijon:

- përfaqëson dhe vepron si agjent i komunës;
- kontrollon legalitetin e rregulloreve të kuvendit;
- publikon rregulloret e këshillit në buletinin zyrtar të komunës;
- siguron zbatimin e vendimeve të kuvendit;
- siguron kryerjen e aktiviteteve të deleguara në komunë sipas ligjit;
- inicion dhe propozon miratimin e rregulloreve që bien në kompetencë të kuvendit;
- propozon buxhetin vjetor dhe pasqyrat vjetore të buxhetit të komunës;
- ekzekuton buxhetin e komunës;
- zgjedh menaxherët e agjencive publike, të themeluara nga komuna, në bazë të një konkursi publik;
- rregullisht informon kuvendit për kryerjen e kompetencave të veta në pajtim me statutin;
- zgjidh çështjet administrative në pajtim me ligjin, statutin ose rregulloret tjera të kuvendit;
- miraton manualin e personelit për administratën e komunës;
- menaxhon administratën e komunës;
- vendos për rekrutimin, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të punësuarve me administratën komunale, përveç kur me ligj përcaktohet ndryshe;
- siguron përdorimin e rregullt dhe ligjor, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e pasurisë së komunës, në pajtim me ligjin dhe statutin; dhe
- kryen aktivitete të tjera të përcaktuara me ligj dhe statut.

Kryetari komunës gëzon **imunitet material**, pra nuk mund të mbahet përgjegjës ose të burgoset për pikëpamjet ose mendimet e shprehura në kuvend. Ajo/ai vendos se cili anëtar i kuvendit e zëvendëson atë në rastet e mungesës ose pamundësisë për të ushtruar funksionin e kryetarit të komunës. **Kryesuesi i kuvendit** të komunës nuk mund të jetë në mesin e personave që zëvendësojnë kryetarin e komunës, zgjidhje kjo e njëjtë si në Kosovë dhe në vendet tjera përreth që dikur i kanë takuar ish-**Jugosllavisë**. Kryetari i komunës nuk mund të jetë anëtarë i trupave mbikëqyrës, administrativ dhe kontrollues të

shoqatave tregtare, ndërmarrjeve publike dhe institucioneve. Ajo/ai nuk mund të merr pjesë në procesin e vendimmarrjes në çështjet në të cilat është bashkëshort, fëmijë ose i afërm i rendit të dytë me palën që ka interes financiar ose tjetër interes personal.

Mandati i kryetarit të komunës përfundon sipas fuqisë së ligjit në këto raste:

- dorëheqjes;
- vdekjes;
- dënimit me formë të prerë për një vepër penale me dënim më shumë se gjashtë (6) muaj;
- privimit pakthim me vendim të organit kompetent nga zotësia e veprimit;
- papajtueshmërisë së funksionit sipas Ligjit mbi zgjedhjet lokale;
- mungesës së paarsyeshme më gjatë se gjashtë (6) muaj; dhe, së fundit,
- pushimi i të qenit banor i komunës.

Administrata e komunës organizohet për kryerjen e aktiviteteve që bien në kompetencë të trupave komunal. Organizohet nëpër sektorë dhe departamente. Organizimi, caqet dhe mënyra e kryerjes së detyrave të administratës publike përcaktohet nga kuvendi, bazuar në propozimin e kryetarit të komunës. Të punësuarit në administratën komunale, që kryejnë detyra profesionale, juridiko-normative, ekzekutive, administrative, mbikëqyrëse dhe që vendosin për çështje administrative, kanë statusin e shërbyesve publik. Një përfaqësim i drejtë dhe i barabartë i qytetarëve të të gjitha komuniteteve si dhe profesionalizmi e kompetenca e tyre, respektohen me rastin e rekrutimit të të punësuarve në institucionet dhe administratën publike të themeluar nga komunat. Një zgjidhje e ngjashme ekziston sa i përket administratës komunale në vendet tjera përreth Kosovës.

Një ngjashmëri e tillë ekziston edhe në raport me **demokracinë e drejtpërdrejtë**, që është thuajse e njëjtë me vendet tjera përreth Kosovës: qytetarët marrin pjesë drejtpërdrejt në vendimmarrje sa i përket çështjeve me relavancë lokale, përmes **iniciativave të qytetarëve**, **tubimeve publike** dhe **referendumeve**. **Iniciativa qytetare** ka të bëj me të drejtën e qytetarëve për t'i propozuar kuvendit miratimin e një akti me qëllim të zgjidhjes së çështjeve të caktuara në kuadër të kompetencave të tij. Nëse propozimi mbështetet më së paku nga 10% e votuesve, atëherë ai propozim duhet të diskutohet në kuvend sipas kushteve të përcaktuara me statutin e komunës, ose së paku brenda nëntëdhjetë (90) ditësh. **Tubimi publik** i qytetarëve mund të thirret për krejt komunën ose vetëm për një pjesë të saj. Tubimi thirret nga kryetari i komunës, sipas iniciativës së saj/tij, apo me kërkesën e së paku 10% të elektoratit të komunës ose të pjesë së komunës me të cilën ka të bëj tubimi. Tubimi mund të miratoj udhëzimet e përgjithshme lidhur me punën e organeve komunale me shumicë votash të personave që janë prezent dhe votojnë. Trupat lokale janë të detyruara të marrin parasysh këto udhëzime përmes miratimit të akteve apo vendimeve brenda nëntëdhjetë (90) ditësh. Kuvendi i njësisë zgjedhore mund të lëshoj një njoftim për referendum me vetiniciativë lidhur me çështjet brenda kompetencës së tij, ose me kërkesë të 20% të votuesve. Vendimi i miratuar në referendum është i detyrueshëm për kuvendin.

Prona e komunës përbëhet nga toka, pajisjet, paratë dhe të drejtat. Komunat mund të disponojnë dhe menaxhojnë asetet e tyre në mënyrën e përcaktuar sipas ligjit. Ligji mbi financimin e autoriteteve lokale normon procesin e decentralizimit fiskal. Burimet e të ardhurave komunale janë për sa vijon:

- **taksat lokale** (taksat në pronë, taksat nga trashëgimi e dhuratat, taksat mbi patundshmërinë dhe transaksionet, 100 % e taksave në të ardhurat personale për zejtarët individual); këto taksa administrohen nga vetë autoritetet lokale;
- **taksat lokale** (taksat për shërbimet komunale, taksat administrative); njësitë e vetëqeverisjes lokale janë të autorizuara për të përcaktuar vetë shkallën e taksave dhe mbledhjen e tyre;
- **tatimet lokale** (tatimi për rregullimin e tokës së ndërtimit, tatimi për planet hapësinore dhe urbane, tatimet për shfrytëzim të shërbimeve komunale); autoritetet komunale administrojnë tatimin

për administrimin e tokës ndërtimore si dhe tatimet për planet hapësinore urbane dhe rurale; shërbimet lokale të dërgimit ofrohen nga kompanitë e shërbimeve dhe konsumatorët paguajnë për shërbimet e tyre;
- **taksat në pronë** (të hyrat nga shitja e pronës, renta e tokës, të hyrat nga kamatat e interesit); këto shërbime përcaktohen dhe mblidhen nga autoritetet lokale;
- **të hyrat nga dënimet** (këto të hyra përcaktohen dhe mblidhen nga autoritete lokale për rastet e shkeljes së rregullave komunale);
- **donacionet**, të vendit dhe të huaja (rregullohen me një marrëveshje mes donatorit dhe kryetarit të komunës);
- kontributet lokale vullnetare;
- huat (komunat kanë nevojë për autorizim nga qeveria për marrje të huas);
- subvencionet (fondi për rajonet e pazhvilluara, fondi për aktivitete e shërbimeve komunale dhe rrugët, fondi për tubat e ujit dhe të ujërat e zeza);
- **grantet** (granet me destinim, grantet pa destinim, grantet bllok për shpenzimet; grantet për investime kapitale; grantet për kompetencat e deleguara);

Në të hyrat e ndara, pra ku merr pjesë edhe pushtetit qendror, hyjnë edhe një përqindje e caktuar e taksave në të ardhurat personale dhe të hyrat nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

Edhe në Maqedoninë e Veriut ekziston kontrolli i mënyrës së funksionimit të njësive të vetëqeverisjes lokale lidhur me zbatimin e kompetencave të tyre dhe ka të bëj me **kontrollin e ligjshmërisë** dhe **kontrollin operacioneve financiare**. Kontrolli i funksionimit të trupave komunale me funksione të deleguara nën kompetencën e trupave të administratës publike përfshinë **mbikëqyrjen e ligjshmërisë** dhe **mbikëqyrjen e efikasitetit** të kryerjes së funksioneve të deleguara. Në rastet e përcaktuara me ligj, duhet të ekziston një mbikëqyrje paraprake. Trupat komunale janë të detyruara të bashkëpunojnë me trupat mbikëqyrëse. Mbikëqyrja e ligjshmërisë e rregulloreve të komunës kryhet nga ministria përgjegjëse për kryerjen e funksioneve lidhur me qeverisjen lokale. Në pajtim me **Ligjin për auditimin, Zyra shtetërore e auditimit** kryen auditimin e operacioneve financiare të komunave. Trupi administrativ shtetëror, kompetencat e të cilit janë deleguar në komunë, kryen mbikëqyrjen e kompetencave të deleguara.

Marrëdhëniet mes komunave dhe pushtetit qendror gjithashtu janë të normuara më KMVe, ligj dhe akte të tjera juridike. Komunat konsultohen me kohë dhe sipas procedurës përkatëse lidhur me planifikimin dhe vendimmarrjen mbi çështjet që kanë të bëjnë me to. Ato gjithashtu konsultohen lidhur me çështjet publike gjatë përgatitjes së planit hapësinor të Maqedonisë së Veriut, në pajtim me **Ligjin për vetëqeverisjen lokale**. Ky ligj përcakton mënyrën e konsultimit. Me qëllim të koordinimit të punëve gjatë planifikimit, programimit dhe implementimit të politikave në sferat e veçanta ose në një grup të tyre, **QeMVe** mund të nënshkruaj marrëveshje mbi bashkëpunimin me një ose disa komuna në sferat apo sektorët e interesit reciprok. Kuvendi i Maqedonisë së Veriut informohet lidhur me marrëveshjet e tilla rregullisht. QeMVe bashkëpunon rregullisht me komunat në çështjet që janë në interes të tyre, siç janë:

- ligjet që zbatohen në komuna;
- shkalla e subvencioneve të përgjithshme që alokohen në komuna gjatë vitit kalendarik;
- burimet e financimit të kompetencave.

Mbrojtja juridike e vetëqeverisjes lokale në Maqedoninë e Veriut është shumë e ngjashme me vendet tjera përreth Kosovës. Kuvendi dhe Kryetari i Komunës mund të nisin iniciativën para GJKMVe për vlerësim të kushtetutshmërisë së ligjeve, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve të përgjithshme të ministrive dhe trupave të tjerë të administratës shtetërore me të cilat shkelen të drejtat dhe pozita kushtetuese e komunës, e përcaktuar me KMVe. Përveç mbrojtjes para GJKMVe, komunat gëzojnë të drejtën e mbrojtjes juridike edhe para gjykatave të rregullta, sa i përket akteve dhe veprimeve të

trupave të administratës shtetërore dhe të QeMVe që pengojnë ushtrimin e kompetencave të komunës të përcaktuara me KMVe dhe ligj.

Gjuha maqedonase me alfabetin cirilik është gjuhë zyrtare nëpër komuna. Përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik, gjuha dhe alfabeti që përdoret nga së paku 20% e banorëve të komunës do të jetë gjuhë zyrtare në atë komunë. Kuvendi i komunës vendos për përdorimin e alfabeteve dhe gjuhëve që fliten nga më pak se 20% e banorëve të komunës.

11.4. Mali i Zi

11.4.1. Historiku

Në trajtimin e vetëqeverisjes lokale në Mal të Zi, krahas teksteve juridike që janë në fuqi, me fillim nga **KMZi** e deri te aktet nënligjore, jemi bazuar në dy librat kryesore të së drejtës kushtetuese dhe vetëqeverisjes lokale në këtë vend, të autorëve të mirënjohur: Miat Shukoviq (Mijat Šuković: 1930-2011)[120] dhe Xhorxhe Blazhiq (Đorđije Blažić).[121]

Lindja dhe zhvillimi i qeverisjes lokale në Mal të Zi, deri me themelimin e Jugosllavisë (1 dhjetor 1918), përputhet me zhvillimin e shoqërisë malazeze. Këtu nuk dallon shumë nga shoqëritë tjera përreth Kosovës. Zhvillimi i saj mund të ndahet në tri periudha, si vijon: periudha e parë, ajo e fiseve, që përfshinë tërë kohën e sundimit otoman deri në miratimin e Ligjit të përgjithshëm malazez dhe të maleve **në vitin 1798. Ky ndryshe njihet si Kodi i Pjetrit të Parë** (Petar I. Petrović Njegoš: 1748-1830). Periudha e dytë nis me fillimin e krijimit të shtetit malazez nën sundimin e princit **Danilo** (Danilo Aleksandar Petrović-Njegoš: 1872-1939). Dhe, e treta, periudha që përputhet me themelimin e **Malit të Zi** si shtet sovran dhe bashkimin e tij t**ë** dhunshëm me Jugosllavinë (humbja e shtetësisë më 1918), përkatësisht koha e sundimit të princit dhe (më vonë) mbretit **Nikola** I (Nikola I Petrović-Njegoš: 1841-1921). Ne këtu nuk flasim për këto periudha, meqë një gjë e tillë tejkalon caqet e natyrës së librit tonë. Mjafton të fillojmë nga pavarësimi i këtij vendi (2006) deri më sot, duke anashkaluar edhe periudhën e ish-Jugosllavisë (1918-1992), meqë **Mali i Zi**, në aspektin e vetëqeverisjes lokale, nuk ka dalluar nga koncepti i përgjithshëm i normuar me kushtetutat jugosllave të kohës.[122] Këto dimensione të vetëqeverisjes lokale i kemi trajtuar gjerësisht në seksionin për **Kosovën** dhe **Maqedoninë e Veriut** dhe do të trajtohen tutje më poshtë sa i përket vetëqeverisjes lokale në **Serbi**.

11.4.2. Kuadri pozitivo-juridik deri në pavarësimin e Malit të Zi

Vetëqeverisja lokale e sotme në **Mal të Zi** ka lindur dhe është krijuar njëkohësisht me kushtet nën të cilat u krijua edhe në Serbi, me një zhvillim pak më dinamik të sistemit shoqëroro-ekonomik dhe politik, që ka rezultuar në një sërë specifikash. Me kalimin në sistemin e tregut të hapur që bazohet në ekonominë e lirë dhe afirmimin e sistemit shumëpartiak politik dhe demokracisë parlamentare, u krijuan kushtet e reja për krijimin e një sistemi të ri të organizimit dhe ushtrimit të pushtetit. Në nivel qendror futet sistemi i ndarjes së pushtetit, në pushtetin legjislativ, që e ushtron kuvendi malazez, pushtetin ekzekutiv, që e ushtron qeveria e Malit të Zi, dhe pushtetin gjyqësor, që e ushtrojnë gjykatat me **Gjykatën Supreme të Mali të Zi** (GJSMZi), si instanca e fundit e gjyqësorit të rregullt. Futet institucioni i Presidentit të Republikës, që përfaqëson republikën, kurse kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë vazhdon ta ushtroj **Gjykata Kushtetuese e Malit të Zi** (GJKMZi), por sipas parametrave esencialisht të ndryshëm nga

120 Mijat Šuković, *Ustavno pravo* (CID: Podgrica, 2009).

121 Đorđije Blažić*, Sistem lokalne samouprave* (Teorijsko, međunarodno-pravno, komparativno i pozitivno-pravno) (Fakultet za državne i evropske studije – Podgorica, 2011).

122 Cf. gjerësisht lidhur me vetëqeverisjen lokale në Mal të Zi gjatë Jugosllavisë komuniste në Dragutin Papović, "ADMINISTRATIVNO-TERITORIJALNA PODJELA I LOKALNA SAMOUPRAVA U CRNOJ GORI 1945-1963". *Montenegrin Journal for Social Sciences* Vol. 4 Issue 1 (2020), fq. 35-57.

ata që kishin ekzistuar në mbrojtjen e kushtetutshmërisë e ligjshmërisë nën Jugosllavinë komuniste (**GJKMZi** ka nisur të funksionoj që nga vitit 1963, së bashku me gjykatat kushtetuese të ish-republikave jugosllave). Në nivel lokal braktiset **sistemi komunal** i dikurshëm, që ishte futur sipas **KJ 1963**, dhe futet sistemi i vetëqeverisjes lokale, në kushtet e një përkufizimi mes sferës qendrore (shtetërore) dhe sferës vetëqeverisëse (lokale) të pushtetit. Në fushën vetëqeverisëse, komunitetet apo bashkësitë lokale janë autonome (të mëvetësishme) në miratimin e dispozitave dhe kryerjen e punëve nga kompetenca e tyre, me pjesëmarrje aktive të popullsisë lokale në drejtimin e punëve me interes të drejtpërdrejtë dhe të interesit të përbashkët për krejt qytetarët e komunitetit lokal. Procesi i dekoncentrimit të punëve të administratës shtetërore në organet e vetëqeverisjes lokale, ku vjen deri te zgjerimi i kompetencave dhe autorizimeve të vetëqeverisjes lokale, ka filluar me miratimin e këtyre akteve juridike: **Ligjit të parë të Malit të Zi mbi vetëqeverisjen lokale** (1991), **Kushtetutës së Malit të Zi** të vitit 1992 (KMZi 1992), akoma brenda **RFJ-së** (Serbi dhe Mali i Zi), shteti federal që u krijua si një shtet i ri nga Millosheviqi në prill të vitit 1992 në gërmadhat e ish-Jugosllavisë, **Ligjit për kryerjen e punëve të administratës shtetërore nga organet e vetëqeverisjes lokale** (1992) dhe, së fundi, Rregullorja e Qeverisë së Malit të Zi për besimin e punëve të administratës shtetërore vetëqeverisjes lokale (1992).

Me **KMZi 1992** përcaktohet që kryeqytet i vendit është **Podgorica**, kurse kryeqytet historik (vendi i kurorës së Malit të Zi) – **Cetinja.** Me ligj, në pajtim më KMZi, rregullohet sistemi i vetëqeverisjes lokale (neni 12.1 nën pikën 3 i **KMZi** 1992). Në kuadër të pjesës së dytë të KMZi, pjesës mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, garantohet e drejta për vetëqeverisje lokale (neni 66.1 i **KMZi 1992**). Vetëqeverisja realizohet në komunë dhe në kryeqytet (neni 66.2 i KMZi). Qytetarët në vetëqeverisje lokale vendosin drejtpërdrejtë dhe përmes përfaqësuesëve të zgjedhur lirisht mbi disa punë publike dhe të tjera që kanë interes të drejtpërdrejtë për qytetarët lokal (neni 66.3 i **KMZi 1992**). Organet e vetëqeverisjes lokale në komunë janë: kuvendi dhe kryetari i kuvendit (neni 66.4 i **KMZi 1992**). Republika ndihmon vetëqeverisjen lokale (neni 66.5 i **KMZi 1992**). Disa punë të administratës shtetërore mund t'i besohen për kryerje vetëqeverisjes lokale, institucioneve ose personave juridik (neni 99.2 i **KMZi 1992**).

Pas nxjerrjes së **KMZi** 1992, me **Ligjin për kryeqytetin historik** (vendin e kurorës) në vitit 1993, veçanërisht pas ndryshimeve dhe plotësimeve të vitit 1995 **në Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale**, në sistemin e vetëqeverisjes lokale malazeze u bënë ndryshime të rëndësishme, të cilat konsistojnë në karakteristikat për sa vijon: ndryshimi i pozitës juridiko-kushtetuese të vetëqeverisjes lokale, decentralizimi i pushtetit, afirmimi i mëtejshëm i parimit të autonomitetit (mëvetësisë) së bashkësive apo komuniteteve lokale, organizimi i pushtetit lokal në parimet e ndarjes së pushtetit dhe kështu me radhë. Procesi i decentralizimit i nisur me ndryshimet dhe plotësimet **në Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale**, me të cilin u zgjeruan në mënyrë të konsiderueshme fushat e veprimit të vetëqeverisjes lokale, afirmimin e mëtutjeshëm e jetëson në një sërë ligjesh materiale, gati nga secila sferë e jetës shoqërore. Një decentralizim i thellë, megjithatë, ndodhi vetëm pas reformave të nisura më 1998 në sistemin e vetëqeverisjes lokale, të cilat ndodhën në një ambient juridiko-politik rrënjësisht të ndryshuar në **Mal të Zi**. Sikundër dihet, ky vend ndryshoj pozitën e vet juridike – kushtetuese më 1992, kur u themelua RFJ nga diktatori serb **Sllobodan Millosheviq**, në rrënojat e ish-Jugosllavisë, si njëri prej pesë shteteve të reja (Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Maqedonia e Veriut, Sllovenia dhe RFJ). Ky ndryshim radikal kushtetues, fillimisht nuk u reflektua në sistemin e qeverisjes lokale, në ndërkohë që konfliktet politike mes Serbisë dhe Malit të Zi vazhduan edhe pas rënies së regjimit të Sllobodan Millosheviqit në vitin 2000, përkundër ndryshimeve në udhëheqjen e re serbe. Kjo gjendje kulmoj me themelimin e **BSHSMZi** në vitin 2003, një formacion i ri shtetëror që formën e vetë kushtetuese e ka marrë me **Kartën Kushtetuese të Serbisë dhe Malit të Zi** ("Karta Kushtetuese") të 4 shkurt 2003.[123] As ky ndryshim radikal politik dhe statusor

[123] **Grundnorma** e Kartës Kushtetuese gjendet në **Marrëveshjen mbi parimet e marrëdhënieve mes Serbisë dhe Malit të Zi në kuadër të bashkësisë shtetërore**, e njohur si "Marrëveshja e Beogradit", e nënshkruar më 14 mars 2002 në Beograd mes përfaqësuesve të dy njësive federale të RFJ – Serbisë dhe Malit të Zi. Tekstin e **Marrëveshjes së Beogradit** më pastaj e kanë miratuar kuvendet e Serbisë dhe Malit të Zi, ndaras, kurse më 4 shkurt 2003, **Kuvendi i RFJ** e ka miratuar **Kartën Kushtetuese**, si aktin më të lartë juridik të **BSHSMZi**, ashtu siç përcaktohej me dispozitat e **Marrëveshjes së Beogradit**.

i Malit të Zi në raport me Serbinë nuk rezultoi me harmonizim të marrëdhënieve politike mes elitave politike në Serbi dhe Mal të Zi: mospajtimet politike mes udhëheqësive politike të këtyre dy vendeve morën përmasa edhe më të thella në këtë kohë. Këto marrëdhënie të këqija bënë që Kuvendi i Malit të Zi (KuvMZi) të merr vendim për shpalljen e referendumin për pavarësinë e vendit, i cili u mbajt më 21 maj 2006, në të cilin qytetarët e Malit të Zi vendosën për pavarësinë dhe sovranitetin e tyre. Me **Vendimin për shpalljen e pavarësisë** dhe Deklaratën mbi pavarësinë e Malit të Zi, që i miratoj KuvMZi me 3 qershor 2006, ky vend u konstituua si shtet sovran dhe i pavarur me subjektivitet të plotë juridikondërkombëtar. Vitin në vijim u miratua KMZi.

Në periudhën mes viteve 2003-2009 janë miratuar të gjitha ligjet sistemore dhe nënsitemore nga lëmia e vetëqeverisjes lokale. Më 2003 u miratuan: **Ligji mbi vetëqeverisjen lokale**, **Ligji për financimin e vetëqeverisjes lokale**, **Ligji mbi zgjedhjen e kryetarëve të komunave**. Më 2006, pas pavarësisë, u miratua edhe **Ligji mbi kryeqytetin e Malit të Zi**. As në këtë periudhë, megjithatë, nuk janë miratuar të gjitha ligjet jo sistemike dhe as nuk qe bërë harmonizimi i ligjeve materiale nga disa lëmi të jetës shoqërore me sistemin e ri, ligje që janë të rëndësishme për vetëqeverisjen lokale. Me zgjidhjet e reja ligjore në lëmin e vetëqeverisjes lokale u rregullua mënyra e realizimit të saj, pozita juridike e bashkësive apo komuniteteve lokale, punët e tyre, mënyra dhe procedura e zgjedhjes së kryetarit të komunës, bashkëpunimi dhe format e bashkimit të bashkësive apo komuniteteve lokale, marrëdhëniet e organeve shtetërore dhe organeve të vetëqeverisjes lokale, mbrojtja e vetëqeverisjes lokale dhe çështjet tjera të rëndësishme për realizimin e të drejtave të qytetarëve në vetëqeverisje lokale.

Vetëqeverisja lokale në Malin e Zi pas pavarësisë vepron në një ambient shumë më të favorshëm sa i përket realizimit të kësaj të drejte qytetare. Në administratë tanimë është futur sistemi i shërbyesve civil, parimi i depolitizimit të funksioneve administrative, shërbimet publike me qëllim të kryerjes efikase të veprimtarive shoqërore dhe ekonomike të rëndësishme për qytetarin dhe kështu me radhë. Ajo që është më me rëndësi ka të bëj me faktin se vetëqeverisja lokale u ngrit në nivel të kategorisë kushtetuese, kurse e drejta për realizimin e saj, në një të drejtë kushtetuese. Kjo nënkupton që pushtetit administrativ dhe legjislativ iu mundësohet që përmes ligjeve sistemike dhe materiale të afirmojnë tutje vetëqeverisjen lokale në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Koncepti i ri i vetëqeverisjes lokale u ndërtua mbi parime e standarde të njohura të **KEVL**, të cilat në tërësi mishërohen në legjislacionin malazez për vetëqeverisjen lokale, legjislacion që në thelb nuk dallon asgjë nga legjislacioni i **Kosovës** dhe vendeve të tjera të dala ish-Jugosllavia. Bëhet fjalë për parimet për sa vijon:

- demokratizimi i njësive të vetëqeverisjes lokale;
- decentralizimi i pushtetit;
- depolitizimi i funksioneve publike dhe administrative;
- mëvetësia (autonomiteti) dhe përgjegjësia vetjake e njësive të vetëqeverisjes lokale;
- barazia dhe bashkëpunimi i shtetit dhe njësive të vetëqeverisjes lokale;
- ligjshmëria e punës së njësive të vetëqeverisjes lokale;
- puna publike e transparente e njësive të vetëqeverisjes lokale;
- organizimi i pushtetit lokal në parimin e ndarjes së pushtetit;
- kontrolli dhe balancimi i pushtetit lokal;
- zhbllokimi i pushtetit politik (mospengimi i punës së pushtetit lokal);
- profesionalizimi i shërbimeve publike;
- përjashtimi i konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike.

11.4.3. Kuadri juridiko-pozitiv i vetëqeverisjes lokale sot

Kuadri juridiko-pozitiv i vetëqeverisjes lokale në Mal të Zi përbëhet nga sa vijon:

- normat juridiko-kushtetuese;
- ligjet sistemike mbi vetëqeverisjen lokale;
- ligjet josistemike nga lëmi i vetëqeverisjes lokale, siç janë: ligji mbi financimin e vetëqeverisjen lokale, ligji mbi kryeqytetin, ligji për qytetin historik (vendin e kurorës së Malit të Zi), organizimin territorial të vendit dhe kështu me radhë;
- një mori ligjesh materiale nga sfera të ndryshme të jetës dhe punës shoqërore;
- rregulloret dhe aktet tjera të qeverisë me të cilat disa punë të administratës shtetërore i besohen vetëqeverisjes lokale;
- dispozitat lokale të njësive vetëqeverisëse, siç janë: statuti dhe vendimet e komunave si akte të përgjithshme, si dhe rregulloret e kuvendeve komunale dhe kështu me radhë.

Siç u tha më sipër, me KMZi 1992 u përcaktua që kryeqytet i Malit të Zi do të jetë Podgorica, kurse vendi i kurorës, apo kryeqytet historik do të ngelet Cetinja. Gjatë tërë kohës sa ka ekzistuar **BSHSMZi,** nuk ka ekzistuar një kryeqytet i përbashkët por **Beogradi** dhe **Podgorica** kanë qenë kryeqytetet respektive të dyja vendeve. Me ligj, në pajtim me KMZi 1992, rregullohej sistemi i vetëqeverisjes lokale, zgjidhje kjo kushtetuese e ngjashme me vendet përreth. Baza kushtetuese për këtë ishte pjesa e dytë e KMZi 1992. Për zgjidhjet kushtetuese të kësaj kushtetuese folëm më sipër dhe këtu nuk do t'i ripërsërisim më, por do të kalojmë në zgjidhjet kushtetuese të **KMZi**, pra pas pavarësimit të vendit.

Në vitin 2007, **KMZi** përparon sistemin e vetëqeverisjes lokale. Në aspektin e vendit të saj në **KMZi**, vetëqeverisja lokale radhitet në një pjesë të saj në kuadër të pjesës së dytë mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, kurse në pjesën tjetër normohet me diszpoitat e pjesës së tretë (pika 4) që titullohet "Rregullimi i pushtetit", pas dispozitave kushtetuese mbi **KuvMZi**, Presidentin e Malit të Zi (PrMZi) dhe Qeverinë e Malit të Zi (QeMZi). Ky sistemim tregon për **karakterin e dyfishtë të qeverisjes lokale** (njëjtë si në Kosovë dhe vendet përreth): një, vetëqeverisja lokale është një **e drejtë e qytetarëve**; dhe, dy, vetëqeverisja lokale është **element organizativ i shtetit**. Si **e drejtë e qytetarëve**, vetëqeverisja lokale, garantohet përmes dispozitës kushtetuese të nenit 139 të KMZi, që thotë: "Garantohet e drejta për vetëqeverisje lokale". Si **organizim**, ndërkaq, vetëqeverisja lokale normohet me dispozitat e KMZi lidhur me mënyrën e vendosjes, përcaktimit të vëllimit të të drejtave të qeverisjes lokale, komunën dhe statusin e saj kushtetues, aktet dhe organet e komunës, autorizimet financiare, mënyrën e financimit dhe mëvetësinë e komunës (nenet 113-117 të **KMZi**).

Në raport **me mënyrën e vendosjes** dhe **vëllimin e të drejtave**, **KMZi** përcakton që në vetëqeverisjen lokale vendoset në **mënyrë të drejtpërdrejtë** dhe **përmes përfaqësueseve** të zgjedhur lirshëm, kurse **e drejta në vetëqeverisjen lokale** përfshinë të drejtën e qytetarëve dhe organeve të vetëqeverisjes lokale për rregullim dhe drejtim të punëve të caktuara publike, në bazë të përgjegjësisë vetjake dhe në interes të popullsisë lokale (neni 113 i KMZi). Sikundër u pa më herët, vetëqeverisja si e drejtë e njeriut u përcaktua në KMZi 1992, si dhe mënyra e vendosjes dhe organet e saj, në ndërkohë që stipulimi sa i përket përgjegjësisë dhe interesit të pjesëmarrësve në vetëqeverisje lokale paraqet progres në statusin juridiko-kushtetues të kategorisë së vetëqeverisjes lokale, e cila tani fiton cilësinë e një garancioni kushtetues shprehimor, duke shndërruar përgjegjësinë dhe interesin vetjak vetëqeverisës si elemente të reja kushtetuese. Në raport me **formën e vetëqeverisjes lokale**, KMZi përcakton që komuna është forma themelore e organizimit të vetëqeverisjes lokale, por mund të themelohen edhe forma të tjetra të vetëqeverisjes lokale (neni 114 i KMZi). Lidhur me **statusin dhe organizimin e komunës**, KMZi përcakton që ajo ka cilësinë e personit juridik, miraton statusin dhe aktet e përgjithshme juridike dhe që organet e komunës janë kryetari dhe kuvendi (neni 115 i **KMZi**). **Autorizimet pronësore dhe autonomia financiare** normohen me dispozitat e **KMZi**, ashtu që tani ato duken si vijon: komuna ushtron

disa autorizime pronësore në sendet në pronësi shtetërore, në pajtim me ligjin; komuna ka pronën e saj; komuna financohet nga të ardhurat vetjake dhe nga të ardhurat e shtetit; dhe, së fundi, komuna ka buxhetin e vet (neni 116 i **KMZi**). **Pavarësia e komunës** sigurohet me dispozitën kushtetuese që thotë se komuna është e pavarur (mëvetësishme) në kryerjen e kompetencave të saj, kurse **QeMZi** mund të shpërndaj kuvendin komunal, përkatësisht shkarkoj kryetarin e komunës vetëm nëse kuvendi i komunës, përkatësisht kryetari nuk ushtrojnë kompetencat e tyre më shumë se gjashtë muaj me radhë (neni 117 i **KMZi**). Të gjitha këto zgjidhje kushtetuese në Mal të Zi, sikundër mund të vërehet, janë shumë të ngjashme konceptualisht dhe përmbajtjesisht me zgjidhjet kushtetuese në vendet përreth Kosovës, përveç faktit që në disa prej tyre ato kanë statusin e dispozitave ligjore, pra nuk kanë rang kushtetues siç kanë në Mal të Zi. Kjo vlen veçanërisht për zgjidhjet e sipërcekura kushtetuese nga neni 117 i **KMZi**, të cilat nuk hasen në kushtetutat tjera të vendeve përreth, përfshirë **Kosovën**. Në literaturë është vërejtur se e drejta për vetëqeverisje në Mal të Zi është një e drejtë natyrore, që shteti vetëm e garanton dhe mbron, por nuk ua jep (njeh) qytetarëve: ajo supozohet se ka ekzistuar si e drejtë para çdo kushtetute malazeze.[124]

Sa i përket **kuadrit ligjor të vetëqeverisjes** në Mal të Zi, ai gjithashtu nuk dallon shumë nga kuadri ligjor i vendeve përreth Kosovës. Në këtë vend ekzistojnë një mori ligjesh sistemike dhe josistemike që rregullojnë lëmin e vetëqeverisjes lokale. Në grupin e **ligjeve sistemike** hyjnë me sa vijon:

- **Ligji mbi vetëqeverisjen lokale;**
- **Ligji mbi financimin e vetëqeverisjes lokale;**
- **Ligji mbi zgjedhjen e kryetarit të komunës;**
- **Ligji mbi ndarjen e Malit të Zi në komuna;**
- **Ligji mbi kryeqytetin historik (kurorën e Malit të Zi);**
- **Ligji mbi zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve;** dhe
- **Ligji mbi kryeqytetin.**

Në grupin e **ligjeve josistematike**, ndërkaq, vlen të përmenden për sa vijon:

- **Ligji mbi veprimtaritë komunale;**
- **Ligji mbi lagjet;**
- **Ligji mbi ndërtimet e objekteve;**
- **Ligji mbi rregullimin e hapësirës;**
- **Ligji mbi tokën ndërtimore;**
- **Ligji mbi ujërat;**
- **Ligji mbi tokën bujqësore dhe kështu me radhë.**

Edhe kuadri **nënligjor i vetëqeverisjes** malazeze është i ngjashëm me vendet përreth Kosovës. Me disa rregullore të QeMZi, organeve të vetëqeverisjes lokale i besohet kryerja e disa punëve të administratës shtetërore, siç janë, ta zëmë, punët e inspektimit ndërtimor. Me statut dhe aktet të tjera të kuvendeve komunale, vetëqeverisja lokale në mënyrë të pavarur, brenda kufijve të përcaktuar ligjor, normon marrëdhëniet në nivel lokal në sfera të ndryshme të jetës shoqërore, njëjtë siç bëhet edhe në vendet tjera përreth Kosovës.

11.4.4. Kompetencat e vetëqeverisjes lokale

Kur bëhet fjalë për kompetencat e vetëqeverisjes lokale, duhet theksuar se ato nuk përcaktohen vetëm me dispozitat e ligjeve sistemike mbi vetëqeverisjen lokale: një numër i madh i ligjeve materiale përcakton një mori kompetencash të bashkësive lokale. Analiza e ligjeve materiale nga lëmitë e caktuara të jetës shoqërore tregon se ligjet materiale nga fushat e ndryshme caktojnë një mori

[124] Đorđije Blažić, *Sistem lokalne samouprave*, fq. 240.

punësh që kryhen nga vetëqeverisja lokale. Ato fusha janë, ta zëmë, në sferat për sa vijon: bujqësia, pylltaria, ekonomia ujore, ekonomia, sistemi i të hyrave dhe shpenzimeve publike, ekologjia, administrata e përgjithshme, vendosjes së qytetarëve, mbrojtjes sociale dhe sigurimit material, shëndetësisë, arsimit dhe edukimit, kulturës dhe sportit, lëmit urbanistik, komunale dhe të banimit, informimit, botimit dhe kështu me radhë.

Legjislacioni malazez ka futur konceptin e ri të modelit të kombinuar të përcaktimit të punëve të vetëqeverisjes lokale (sistemi i enumeracionit taksativ dhe i klauzolës së përgjithshme) krahas përcaktimit të prezumimit të kompetencës në favor të vetëqeverisjes lokale për punët që nuk janë të përcaktuara si kompetencë e organeve shtetërore ose organeve të tjera dhe organizatave që ushtrojnë (kryejnë) autorizimeve publike. Me futjen e kompetencës së prezumuar në favor të vetëqeverisjes lokale është braktisur koncepti i mëhershëm sipas të cilit prezumimi i kompetencës ishte në favor të ministrive dhe organeve të tjera shtetërore, kurse vetëqeverisja lokale kryente vetëm punët e përcaktuara me ligj ose dispozita të tjera.

Duke u nisur nga përcaktimi kushtetues i KMZi mbi kompetencën e vetëqeverisjes lokale, sistemi i ri ka ruajtur **katër grupe** të punëve që kryejnë njësitë e vetëqeverisjes lokale. Në grupin e parë hyjnë **punët e detyrueshme vetjake** të vetëqeverisjes lokale. Në të dytin hyjnë të ashtuquajturat **punët e prezumuara**. Grupin e tretë e përbëjnë punët e bartura (deleguara). Dhe, të fundit, grupin e katërt e formojnë **punët e besuara**.

Punët vetjake, sipas natyrës së tyre janë punë që vetë i rregullon dhe përcakton vetëqeverisja lokale, i financon nga burimet vetjake dhe përkujdeset për kryerjen e tyre. Përveç kësaj karakteristike, punët vetjake i karakterizon edhe pavarësia (mëvetësia) e kryerjes së tyre, që manifestohet në zbatimin e procedurës administrative në shkallë të parë dhe në shkallë të dytë në nivel lokal, përkatësisht në pamundësinë e organeve të shtetit për të disponuar me autorizime mbikëqyrje të shkallshmërisë. Sa i përket mbikëqyrjes ndaj kryerjes së punëve vetjake, sigurohet vetëm mbrojtja gjyqësore në procedurën e rregullt administrativo-gjyqësore. Këtu vjen në shprehje vetëm mbrojtja gjyqësore. Me konceptin kësisoj të pozitës së punëve vetjake në sistemin e vetëqeverisjes lokale, në fakt është bërë implementimi i modelit anglez, që cili siguron autonomitetin e plotë të vetëqeverisjes lokale në kryerjen e punëve nga kompetenca vetjake dhe përqendrimin e kontrollimit të ligjshmërisë së kryerjes së tyre vetëm në organet e drejtësisë (gjyqësore), jo në organet administrative shtetërore. Në grupin e **punëve e detyrueshme vetjake** hyjnë ato punë që i ka përcaktuar Ligji mbi vetëqeverisjen lokale dhe ligjet tjera materiale. Në grupin e **punëve të prezumuara** hyjnë punët që nuk janë të përcaktuara me ligj e dispozita të tjera si kompetencë e punëve të organeve shtetërore dhe organizatave. Edhe këtu hyjnë në grupin e punëve vetjake të vetëqeverisjes lokale. Për kryerjen e këtyre punëve, që konsiderohen se janë në interes të drejtpërdrejtë të qytetarëve, sipas definimit të ligjvënësit, komunat në Mal të Zi themelojnë **organet e administratës lokale** dhe themelon **shërbime publike lokale**.

Grupin e tretë dhe të katërt të punëve që i kryen vetëqeverisja lokale përbëhet nga punët e **deleguara** (të bartura dhe të besuara). Sipas karakterit të tyre, punët e deleguara janë punë shtetërore që delegohen për kryerje në njësitë e vetëqeverisjes lokale. Punët e bartura dhe të besuara kanë një sërë karakteristikash të përbashkëta, por edhe dallime. Karakteristikë e tyre e përbashkët shihet në sa vijon:

- detyrimin e shtetit për financim të kryerjes së tyre;
- bartja ose besimi i tyre mund të bëhet në krejt njësitë e vetëqeverisjes lokale ose vetëm në disa prej tyre;
- me dispozitën për bartje ose besim të punëve mund të përcaktohet dhënia e pëlqimit të organit kompetent shtetëror ndaj akteve mbi punët e kryera

- mbikëqyrja e shkallës së dytë ndaj akteve të organeve të vetëqeverisjes lokale bëhet nga ministritë kompetente.

Organet e njësisë së vetëqeverisjes lokale kanë të drejtën e përshtatjes kushteve dhe nevojave lokale kryerjen e punëve të bartura dhe të besuara, u mor vesh, gjithnjë brenda kufijve të përcaktuara me dispozitat mbi bartjen ose besimin.
Mes punëve të bartura dhe të besuara, megjithatë, ekzistojnë dallime mjaft të rëndësishme, të cilat dallime identifikohen sipas parametrave për sa vijon:

- subjekteve që kanë autorizim për delegim të punëve;
- subjekteve që mund t'iu delegohen punët:
- formës së aktit me të cilin delegohen punët nga shteti në vetëqeverisje lokale; dhe, së fundit
- procedurës së delegimit të punëve.

Kur bëhet fjalë për **subjektet që mund të delegojnë punët në qeverisjen lokale**, ata janë: KuvMZi, e cila mund të bartë punët në vetëqeverisjen lokale, dhe **QeMZi** që mund të besoj kryerjen e disa punëve në vetëqeverisje lokale. Lidhur me **rrethin e subjekteve** të cilëve mund t'u delegohen punët, ligjvënësi malazez është orientuar për një rreth të ngushtë të subjekteve në të cilët mund të barten punët (vetëqeverisja lokale), kurse për besim të punëve mund të përzgjidhet një rreth më i gjerë i subjekteve, përfshirë institucionet dhe personat juridik. Kjo materie normohet me **Ligjin për administratën publike**. Për dallim nga bartja e punëve, ku nuk ekziston ndonjë procedurë e posaçme, në procedurën e besimit të punëve në qeverisjen lokale, procedura është e përcaktuar: me rastin e marrjes së vendimit për besim të punëve të caktuara, shqyrtohet elaborimi mbi arsyeshmërinë e besimit në vetëqeverisje lokale për kryerjen nga ana e saj të disa punëve të administratës shtetërore. Së fundit, sa i përket formës së aktit në të cilën shprehet ushtrimi i autorizimit për delegim të punëve në vetëqeverisje lokale, bartja bëhet me ligj kurse besimi i punëve kryhet me rregullore të **QeMZi.**

11.4.5. Organizimi i vetëqeverisjes lokale

Koncepti i ri i vetëqeverisjes lokale, ka hapur çështjen e sistemit lokal zgjedhor për trupat përfaqësues lokal (kuvendet) dhe normimin e këtij sistemi me një ligj të veçantë – **Ligjin për zgjedhjet lokale**. Sistemi aktual i vetëqeverisjes lokale përmban disa karakteristika që lidhen me sistemin lokal zgjedhor. Kur bëhet fjalë për sistemin zgjedhor për trupat përfaqësues lokal – këshilltarët e kuvendit komunal, ligjet aktuale në këtë vend çojnë në tri parime rregullative të këtij sistemi:

- **Parimi territorial zgjedhor**;
- **Parimi zgjedhor i mbështetur në interes**; dhe
- **Parimi personal zgjedhor**.

Parimi i parë, **parimi territorial**, nënkupton futjen e modelit përfaqësues të sistemit zgjedhor. Ky parim shërben për të siguruar përfaqësimin e të gjitha formave të tërthorta të vetëqeverisjes lokale në kuvendin komunal (bashkësitë lokale si njësitë më të imëta brenda njësisë themelore të vetëqeverisjes lokale). Kjo ka për pasojë ndarjen e territorit të komunës në njësi zgjedhore dhe kryerjen e zgjedhjeve për zgjedhjen e përfaqësuesve të njësive të tilla territoriale zgjedhor enë kuvendet e komunave. Në këtë mënyrë sigurohet përfaqësimi adekuat i krejt pjesëve të komunës në procesin e vendosjes dhe realizimit të nevojave të qytetarëve të krejt pjesëve të komunës. Parimi i dytë, **Parimi zgjedhor i mbështetur në interes**, siguron përcaktimin e kushteve të njëjta dhe të barabarta për të gjithë faktorët në komunë, qytetarëve, partive politike, shoqatave të qytetarëve, etj. Në konkurrencën dhe fushatën zgjedhore për këshilltarë në kuvendet komunale. Kjo nënkupton, në të njëjtën kohë, vënien e censusit apo pragut të njëjtë për kandidaturat e të gjithë subjekteve

politikë të interesuar, që më së shpeshti konsiston në përcaktimin e censusit apo pragun adekuat të nënshkrimeve të qytetarëve për paraqitjen e kandidaturës. Parimi i tretë, **parimi personal zgjedhor**, konsiston në sigurimin e kushteve për zgjedhje të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë të përfaqësuesve të kuvendit komunal, sipas parimeve të **sistemit kryesisht mazhoritar zgjedhor**, ku qytetarëve u duhet dhënë mundësia për votim për individin (personin) që kandidohet, jo për listat zgjedhore. Kjo, sikundër shihet, është e njëjtë edhe në Kosovë. E njëjta vlen edhe për zgjedhjen e kryetarit të komunës: ligjvënësi malazez ka përcaktuar zgjedhjen e drejtpërdrejtë të kryetarit të komunës nga ana e qytetarëve.

Në shtjellimin për kuvendin komunal në Mal të Zi, si organ përfaqësues i popullsisë lokale, për qëllimet e krahasimit me Kosovën dhe vendet tjera përreth, me rëndësi janë edhe zgjidhjet ligjore sa i përket çështjeve për sa vijon: **përbërja e kuvendit komunal** dhe **mënyra e konstituimit të saj**. Kur bëhet fjalë për përbërjen e kuvendit, përkatësisht numrin e këshilltarëve, mund të vërehet se ajo është e ndryshme nga një komunë në tjetrën, për shkak se kushtëzohet nga faktorët demokratikë, përkatësisht nga numri i banorëve votues. Kriteret themelore për zgjedhjen e këshilltarëve janë të përcaktuara me **Ligjin për zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve**, sipas të cilit kuvendi i komunës zgjedh 30 këshilltarë dhe nga një këshilltarë plus në çdo 5.000 votues të tjerë. D.m.th., këtu në një ligj, për dallim nga Kosova që këtë e normon me dy ligje të ndara, **Ligjin për zgjedhjet lokale** dhe **Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme**, normohet çështja e kritereve për zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve. Një çështje tjetër me rëndësi është **mënyra e konstituimit** të kuvendit, përkatësisht baza zgjedhore e tij. Si bazë zgjedhore të kuvendeve komunale janë partitë politike, përkatësisht rrethanat e njëjta mbi të cilat qëndron konstituimi i **KuvMZi**, përkundër faktit që funksionet e dy kuvendeve janë tërësisht të ndryshme. Edhe ky dimension është i njëjtë me Kosovën dhe vendet përreth saj.

I njëjtë është edhe fakti që zgjedhjet për kuvend komunal i shpall Presidenti i Republikës. Ato mbahen më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë para skadimit të mandatit të kuvendit aktual. Nëse ato nuk shpallën sipas përcaktimit ligjor, ato i shpall **QeMZi**. Kjo zgjidhje dallon nga Kosova sepse në vendin tonë në asnjë rast qeveria e Kosovës nuk mund të shpallë zgjedhjet lokale. Kuvendi formohet në procedurën e zgjedhjeve të drejtpërdrejta dhe të fshehta që mbahen me pjesëmarrjen aktive të qytetarëve me të drejtë vote në njësinë zgjedhore lokale. Me legjislacionin malazez përcaktohet që qytetarët zgjedhin këshilltarët në bazë të ushtrimit të të drejtës zgjedhore (aktive dhe pasive), në zgjedhje të lira, për të gjithë të qasshme e të barabarta, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë. Funksioni i këshilltarit është i mbrojtur, në kuptimin që nuk mund të thirret në përgjegjësi penale, të burgoset ose dënohet për mendimin e dhënë ose votimin e bërë në kuvendin komunal. D.m.th., bëhet fjalë për **imunitet material.**

Si organi më i lartë lokal përfaqësues i qytetarëve, **kuvendi** kryen një sërë funksionesh, siç janë: **funksionet zhvillimore**, **funskionet normative**, **funksionet e planifikimit**, **funksionet e themelimit**, **funksionet e kuadrit** (personelit) dhe punë të tjera. Së bashku, këto funksione ose punë që kryen kuvendi i komunës në Mal të Zi, që janë thuajse të njëjta me ato në Kosovë dhe vendet përreth (përveç Shqipërisë që ka një sistem pak më ndryshe) mund të përmblidhen për sa vijon:

- miratimi i statutit;
- miratimi i dispozitave dhe akteve të tjera të përgjithshme;
- miratimi i planeve dhe programeve të zhvillimit të komunës;
- miratimi i dokumenteve lokale të planifikimit;
- miratimi i programit për rregullim të hapësirës;
- miratimi i buxhetit dhe llogarisë përfundimtare të buxhetit;
- miratimi i planit të përmirësimit të investimeve kapitale dhe politikës investuese;
- përcakton lartësinë e tatimeve komunale, taksave dhe kompensimeve;

- disponon me pronë dhe pasuri;
- përcakton kushtet për themelimin e bashkësive lokale dhe jep pëlqimin për vendimin mbi themelimin e tyre;
- shpall referendum për territorin e komunës ose për një pjesë të territorit të saj;
- vendos për iniciativën qytetare;
- vendos për shpalljen e vetëkontributit për territorin e komunës;
- themelon shërbime publike;
- vendos për marrjen borxh dhe dhënien e garancioneve, në pajtim me ligjin;
- kryen verifikimin e mandateve dhe vendos për të drejtat e këshilltarëve;
- zgjedh dhe shkarkon kryetarin e kuvendit, kryetarin e komunës, emëron sekretarin dhe anëtarët e trupave punës dhe këshilldhënës;
- paraqet propozimin për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve të organeve shtetërore;
- shqyrton raportet e kryetarit të komunës;
- nxjerrë rregulloren e punës;
- nxjerrë kodin e etikës;
- jep interpretim autentik të dispozitave që ajo vetë i nxjerrë;
- kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe statut.

Me qëllim të kryerjes efikase dhe racionale të punëve nga kompetenca e komunës, formohen **borde** dhe **këshilla**, si trupa punues të përhershëm. Për anëtar të bordeve, kuvendi zgjedh këshilltarët e komunës. Kuvendi mund të formoj komisione si trupa të përkohshëm punës. Për anëtarë të këshillave dhe komisioneve, përveç këshilltarëve, kuvendi emëron edhe persona të tjerë. Me vendimin për themelimin e trupave punues përcaktohet edhe fusha e veprimit dhe mënyra e punës dhe e vendosjes së trupave punues si dhe çështje të tjera të rëndësishme për punën e tyre. Marrë parasysh rëndësinë e disa punëve që janë në kompetencë të kuvendit, ligjvënësi malazez ka kufizuar rrethin e punëve që mund t'u besohen trupave punues. Në raport me kompetencat e deleguara bordeve të komunës, kuvendi mban të drejtën e vlerësimit të ligjshmërisë dhe përshtatshmërisë (oportunitetit) të tyre, që konsiston në detyrimin e bordeve që vendimet e tyre t'i vënë në shikim të kuvendit në seancën e parë të radhës dhe autorizimin e kuvendit që, me vendimin e vet, të anulojë ose shfuqizojë vendimet joligjore dhe të papërshtatshme (jooportune) të bordit dhe të rregulloj ndryshe çështjen e caktuar.

Seancën e parë të kuvendit të sapozgjedhur e thërret kryetari i kuvendit nga përbërja e kaluar, më së voni brenda afatit tridhjetë (30) ditor nga dita e mbajtjes së zgjedhjeve. Nëse seanca në fjalë nuk thirret në këtë afat, atëherë atë e thërret **QeMZi**. Kuvendin e thërret kryetari sipas nevojës, por më së paku një herë në tre muaj. Kryetari thërret atë sipas iniciativës, me kërkesën e kryetarit të komunës, një të tretës (1/3) të këshilltarëve dhe sipas iniciativës së qytetarëve. Kuvendi thirret në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës, përkatësisht iniciativës. Numri i duhur i qytetarëve për paraqitjen e iniciativës për thirrjen e kuvendit, përcaktohet me statut të komunës. **Sistemi i zhbllokimit të punës së kuvendit** sigurohet përmes të drejtës së parashtruesit të kërkesës, përkatësisht iniciativës, që në mënyrë të pavarur të thërrasin kuvendin, nëse kryetari kuvendit nuk e thërret atë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës, përkatësisht iniciativës. Në rastet kur kuvendin e ka thirrur propozuesi i kërkesës, përkatësisht paraqitësi i iniciativës, atëherë kuvendin e kryeson këshilltari që caktohet nga parashtruesi i kërkesës, përkatësisht iniciativës.

Me ndarjen e kuvendit të komunës dhe kryetarit të komunës, ligjvënësi malazez ka synuar ndryshime në udhëheqjen me punë të kuvendit komunal. Në këtë kontekst, ky ligjvënës ka inauguruar **kryetarin e kuvendit** si funksionar lokal që udhëheq me punën e kuvendit dhe përgjigjet për punën e saj, dhe **sekretarin e komunës** si nëpunës profesional që, në aspektin logjistik dhe profesional,

mirëmban punën e kuvendit, të trupave të tij të përhershëm dhe të përkohshëm. Në këtë kontekst, një risi e zgjidhjeve të fundit ligjore në sistemin e vetëqeverisjes lokale në Mal të Zi, ka të bëjë me ndarjen personale të bartësit të punëve normavënëse dhe punëve ekzekutive: përmes konstitutimit të **institutit të kryetarit të kuvendit të komunës**, kryetari i komunës humb autorizimet e thirrjes, kryesimit dhe drejtimit (udhëheqjes) së seancave të kuvendit. Me ligj përcaktohet mënyra e zgjedhjes së kryetarit të kuvendit të komunës, mandati, autorizimet dhe çështje të tjera të rëndësishme për këtë funksion. Kryetarin e kuvendit e zgjedh kuvendi nga radhët e këshilltarëve, me propozimin e një të tretës (1/3) të këshilltarëve. Mandati i kryetarit të kuvendit është i barazuar me mandatin e kuvendit dhe, si funksion, sipas rregullit, është vullnetar. Kryetari i kuvendit mund të shkarkohet para mbarimit të mandatit për të cilin është zgjedhur, në pajtim me statutin e komunës. Kryetari i komunës thërret kuvendin, kryeson dhe udhëheq me punën e kuvendit dhe kujdeset për realizimin e vendimeve dhe akteve të tij. Në rast të mungesës ose pengesës së kryetarit të kuvendit, me kuvend kryesor këshilltari që e cakton kryetari i kuvendit. Ndarja e punëve politike nga punët administrative është kryer nga ligjvënësi me ndryshimin e pozitës juridike të **sekretarit të kuvendit**. Ky post e mban **dimensionin politik**, sepse e emëron kuvendi në një periudhë prej katër (4) vjetësh. Puna e saj/tij, megjithatë, lidhet me përgatitjen e seancave të kuvendit dhe organeve e trupave të kuvendit dhe me koordinimin e aktiviteteve të organeve, organizatave dhe shërbimeve gjatë përgatitjes së seancës së kuvendit. Përtej kësaj, dimensioni administrativ i postit të **sekretarit të kuvendit** ushtrohet përmes udhëheqjes dhe drejtimit të organeve të administratës lokale nga kuadri profesional i administratës lokale, përkatësisht nga **eprorët e organeve**.

Sa i përket vendosjes, si rregull kuvendi vendos nëse në seancë janë të pranishëm shumica e numrit të tërësishëm të këshilltarëve, pra **kuorumi**, zgjidhje kjo e njëjtë me Kosovën dhe vendet tjera përreth sa i përket organit më të lartë përfaqësues në nivel lokal. Vendimet merren në kuvend më shumicën e votave të tyre që janë prezent dhe votojnë, përveç rasteve kur me ligj ose statut për caktohet një shumicë tjetër për çështje të caktuara. Miratimi i statutit të komunës bëhet me shumicën e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve (shumica absolute). Mënyra e punës ë kuvendit, më në detaje normohet me rregulloren e punës së kuvendit. Kur bëhet fjalë për vendosjen në kuvend, me rëndësi të theksohet është çështja e mbrojtjes së këshilltarëve: siç u tha më sipër, nuk ekziston mundësia për mbajtje përgjegjës të këshilltarëve, burgosje ose dënim i tyre për mendimin e dhënë dhe votën e hedhur në kuvend. Me këtë ofrohet siguria e këshilltarëve për ushtrim të funksionit në kuvend (**imuniteti material**).

Gjatë kryerjes së punëve nga fushëveprimtaria e vet, kuvendi miraton akte të ndryshme të përgjithshme dhe individuale. Me këtë rast, kuvendi nxjerr **akte të detyrueshme** dhe **akte fakultative**, me të cilat rregullon marrëdhëniet nga fusha të ndryshme të jetës shoqërore në nivel lokal. Akte të përgjithshme të detyrueshme (dispozita lokale) janë: statuti, rregullorja e punës, buxheti, llogaria përfundimtare, plani hapësinor dhe urbanistik dhe vendimet e përcaktuara me ligj. Akte fakultative të përgjithshme të kuvendit janë: kartat dhe rekomandimet dhe aktet e tjera. Përveç akteve si më sipër, kuvendi nxjerr edhe akte individuale, siç janë aktvendimet dhe konkluzionet.

Një ndër çështjet më të rëndësishme të vetëqeverisjes lokale është edhe mënyra e kryerjes së punëve ekzekutive, në njërën anë, dhe marrëdhëniet mes punëve ekzekutive dhe punëve rregullative, përkatësisht **marrëdhëniet mes kryetarit të komunës dhe kuvendit komunal**, në anën tjetër. Në Mal të Zi, sikundër u pa, me konstitutimin kushtetues të kryetarit të komunës si organ i vetëqeverisjes lokale dhe zgjedhjen e tij nga drejtpërdrejtë nga qytetarët, jo nga kuvendi i komunës, thelbësisht ndryshon edhe roli e pozita e tij në sistemin e vetëqeverisjes lokale. Së bashku me konsitituimin e kryetarit të komunës, vetë KMZi në mënyrë të tërthortë është orientuar kah **modeli monokratik-inokos** i kryerjes së punëve ekzekutive, duke eliminuar modelet tjera, siç janë: **modeli kolegjial** (përmes bordit) i kryerjes së punëve ekzekutive. Nga viti 2003 e deri në janar të vitit 2010, kur ka hyrë në fuqi Ligji malazez për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për vetëqeverisjen lokale, sistemi i vetëqeverisjes

lokale në këtë vend ka funksionuar sipas parimit të ndarjes së pushtetit me variantin e zgjedhjes së organit ekzekutiv nga ana e qytetarëve dhe sistemit të kontrollit dhe balancimit mes kuvendit si organ përfaqësues dhe kryetarit të komunës së organ ekzekutiv. Kjo ka ndryshuar me ndryshimet dhe plotësimet e vitit 2010, kur braktiset parimi i ndarjes së pushtetit dhe në tërësi ndryshohet pozita e kryetarit të komunës në sistemin e vetëqeverisjes lokale. Duke vënë **zgjedhjen e kryetarit të komunës në kuvend komunal**, në tërësi ka ndryshuar pozita juridike e kryetarit të komunës si bartës i funksionit ekzekutiv. Në një sistem juridik ku kryetari i komunës zgjidhet nga kuvendi, më nuk bëhet fjalë për një përfaqësues të qytetarëve, për shkak se funksioni i saj/tij në tërësi orientohet kah nënshtrimi dhe përgjegjësia e plotë ndaj kuvendit komunal, jo qytetarëve. Me ndryshimet e bëra, aktualisht në fuqi, pra, si cilësi themelore e institutit të kryetarit të komunës si bartës i punëve ekzekutive paraqitet **karakteri i tij i dyfishtë**, karakteri lokal dhe shtetëror njëkohësisht. Karakteri lokal buron nga baza e tij zgjedhore (zgjedhja nga kuvendi komunal si trup përfaqësues i qytetarëve) si dhe, në një pjesë të konsiderueshme, për shkak të aspektit funksional, si personalitetit më përgjegjës për kryerjen e punëve nga kompetenca lokale. Karakteri shtetëror i funksionit ekzekutiv shihet në detyrimin dhe përgjegjësinë e kryetarit të komunës për kryerjen e punëve shtetërore, përkatësisht të punëve që shteti i ka bartur ose besuar në vetëqeverisjen lokale. Ky karakter i dyfishtë ka për pasojë edhe përgjegjësinë e dyfishtë të kryetarit të komunës, si **ndaj kuvendit komunal** për sa i takon kryerjes së punëve vetjake të njësisë lokale, dhe **ndaj shtetit**, sa i përket kryerjes së punëve të bartura dhe besuara nga ana e shtetit. Përgjegjësia e saj/tij si bartës i funksionit ekzekutiv për kryerjen e punëve nga kompetenca e vetëqeverisjes lokale realizohet, në njërën anë, **kundrejt kuvendit të komunës** dhe, në anën tjetër, **ndaj QeMZi**. Me ligj përcaktohen çështjet e zgjedhjes së kryetarit të komunës, kohëzgjatja e mandatit, punët, papajtueshmëria e mandatit (konfliktit i interesit), pushimi i mandatit dhe çështje të tjera për ushtrimin e këtij funksioni.

Komuna mund të ketë një ose më shumë nënkryetar, të cilin e zgjedh dhe shkarkon kryetari i komunës. Është rregull i përgjithshëm që mandati i nënkryetarit zgjat aq sa mandati i kryetarit të komunës, përveç rasteve të veçanta, përkatësisht kur kryetarit të komunës i pushon mandati para kalimit të afatit për të cilin është zgjedhur: në këto raste, mandati i nënkryetarit zgjatë deri në zgjedhjen e kryetarit të ri të komunës. Nënkryetari zëvendëson kryetarin e komunës në rast të mungesës së saj/tij ose të pengimit dhe kryen ato punë që ia beson kryetari.

11.4.6. Mbrojtja e vetëqeverisjes lokale

Dispozitat juridike në Mal të Zi i garantojnë komunës mbrojtjen juridike, në pajtim me KMZi dhe ligjin. Në ushtrimin e punëve të vetëqeverisjes, komuna është e pavarur dhe të drejtat e saj nuk mund të cungohen ose kufizohen me aktet e organeve shtetërore, përveç rasteve dhe nën kushtet e përcaktuara me ligj, në pajtim me KMZi. Vetëqeverisja lokale gëzon si format juridike ashtu edhe format jojuridike të mbrojtjes. Forma e fundit të mbrojtjes së të drejtës së qytetarëve në mbrojtjen e vetëqeverisjes lokale bëhet përmes bashkësive lokale, përkatësisht përmes asociacionit të vetëqeverisjes lokale dhe ka të bëj me sa vijon: pjesëmarrjen në përpilimin e ligjeve; dhënien e mendimeve në draft-ligjet që dërgohen në Kuvendin e e Malit të Zi për miratim; vënien në lëvizje të iniciativës drejtuar Presidentit të Republikës për mos shpalljen e ligjit të miratuar në Kuvendin e Malit të Zi; dhe, së fundi, përdorimin e **Këshillit për zhvillim dhe mbrojtje të vetëqeverisjes lokale**. Formë e veçantë të mbrojtjes jojuridike përfaqëson pikërisht formimi i këshillit në fjalë, me qëllim të realizimit të përparimit e vetëqeverisjes lokale në bashkësinë ose komunitetin lokal. Anëtarët e Këshillit i zgjedh kuvendi i komunës nga radhët e qytetarëve të njohur dhe të respektuar të komunës dhe ekspertët nga fushat me rëndësi për vetëqeverisjen lokale. Si natyrës së vet juridike, Këshilli nuk është organ i vetëqeverisjes lokale: përkundër që e zgjedh kuvendi, ai nuk është organ i tij, por as një organ administrativ ose çfarëdo organi tjetër komunal. Ai është një trup këshillëdhënës **sui generis** i komunës dhe qytetarëve, që bazohet në autoritetin e mendimit të shprehur, pa autorizime ekzekutive ose administrative. Për këtë arsye, Këshilli nuk mund të jep urdhëresa asnjë organi ose shërbimi të komunës. Autoriteti ose

pesha morale e mendimeve të tij rrjedh nga struktura etiko-profesionale dhe ekspertiza e përmbajtur në mendimin e tij këshillëdhënës. Këshilli ka të drejtë, megjithatë, që organeve shtetërore, organeve të vetëqeverisjes lokale dhe shërbimeve publike t'iu paraqes propozime për përparim dhe zhvillim të vetëqeverisjes lokale, ngritjen e nivelit të cilësisë së shërbimeve publike, mbrojtjen e të drejtave të garantuara me KMZi dhe ligj dhe detyrimit të komunës për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarëve lokal.

Format juridike të mbrojtjes së vetëqeverisjes lokale realizohen përmes mekanizmave për sa vijon: **mbrojtjes juridiko kushtetuese**, **mbrojtjes administrativo-gjyqësore**, **mbrojtjes së rregullt gjyqësore** dhe **mbrojtjen e veçantë**.

Mbrojtja juridiko-kushtetuese realizohet përmes të drejtës së qytetarëve dhe njësisë së vetëqeverisjes lokale për të parashtruar iniciativën para **GJKMZi** për fillim të procedurës për vlerësimin kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve të përgjithshme të organeve shtetërore, me të cilat cenohen të drejtat për vetëqeverisje lokale e garantuar me KMZi dhe ligj. Gjithashtu, kuvendi i komunës ka të drejtë të nis procedurën për vlerësim të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjera të përgjithshme, me të cilat shkelen të drejtat për vetëqeverisje lokal e garantuar me KMZi dhe ligj.

Kur me akt individual ose me veprimet e organeve shtetërore ose organizatat që ushtrojnë autorizime publike cenohet e drejta e qytetarëve për vetëqeverisje lokale, kurse kundër akteve të tilla ose veprimeve nuk ekziston ndonjë mbrojtje tjetër gjyqësore, atëherë organi kompetent i komunës mund të parashtroj **ankesë kushtetuese** në **GJKMZi.**

Mbrojtja juridiko-administrative sigurohet përmes të drejtës së bashkësisë së vetëqeverisjes lokale që, para gjykatës administrative kompetente, të fillojë procedurë gjyqësore për vlerësim të ligjshmërisë së aktit individual administrativ të QeMZi, ministrisë ose organit tjetër shtetëror, kur konsideron se me aktin e tillë kufizohet ndonjë e drejtë individuale e bashkësisë lokale vetëqeverisëse.
Mbrojtja e rregullt gjyqësore sigurohet përmes të drejtës së bashkësisë lokale vetëqeverisëse që me padi të filloj para gjykatës së rregullt procedurën përkatëse kontestimore kundër shtetit, përkatësisht organeve të tij për shkak të kufizimit të të drejtave pasurore ose të drejtave të tjera të bashkësisë së tillë.

Mbrojtja e veçantë e të drejtës për vetëqeverisje lokale sigurohet edhe para **Avokatit të Popullit**. Realizimi i kësaj mbrojtjeje mund të bëhet nga qytetarët e bashkësisë lokale, por edhe nga organet e vetëqeverisjes lokale nëse me aktet ose veprimet e organeve shtetërore prishet e drejta në vetëqeverisje lokale. Kur e drejta në fjalë shkelet nga organet e vetëqeverisjes lokale, atëherë procedurën para Avokatit të Popullit mund ta nis çdo qytetar i bashkësisë lokale.

11.5. Serbia

11.5.1. Pozita kushtetuese e vetëqeverisjes lokale

Bazat kushtetuese të vetëqeverisjes lokale jo-komuniste në **Serbi** janë vënë me Kushtetutën e vitit 1990 (KSerb 1990). Komuna në **Serbisë** konsiderohet njësi themelore vetëqeverisëse. Krahas **KSerb 1990**, shteti me ligj ka pas konkretizuar mëvetësinë e komunave në dimensionet për sa vijon: vëllimi decentralizimit, të drejtat e vetëqeverisjes lokale, mënyra e përcaktimit të kompetencave lokale, zgjedhja e autorizimet e organeve lokale, mbikëqyrja e organeve qendrore, të ardhurat financiare, e drejta e pronësisë së vetëqeverisjes lokale.
Edhe sipas **KSerb**, aktualisht në fuqi, vetëqeverisja lokale vazhdon të jetë një kategori kushtetuese, krahas autonomisë krahinore. Në fakt, të dyja rregullohen brenda dispozitave të njëjta, si në parimet

themelore ashtu edhe në pjesën përkatëse mbi rregullimin territorial të Republikës së Serbisë (neni 12 lidhur me nenet 176-193 të KSerb). Sikur te krahina autonome, me të drejtën për vetëqeverisje lokale garantohet një hapësirë për kryerjen e punëve lokale, për të cilat nuk janë kompetente organet e pushtetit qendror. Elementet themelore të qeverisjes lokale përcaktohen me KSerb, kurse dispozita më konkrete për këtë gjenden në ligje të tjera, siç janë: **Ligji për vetëqeverisjen lokale**, **Ligji për organizimin territorial të Republikës së Serbisë**, **Ligji për kryeqytetin e Serbisë**, **Ligji për veprimtarinë komunale**, **Ligji për financimin e vetëqeverisjes lokale**. Përveç KSerb dhe ligjeve si më sipër, dispozita të detajuara mbi vetëqeverisjen lokale gjenden edhe në aktet nënligjore dhe në aktet juridike që miraton vetëqeverisja lokale.

Vetëqeverisja lokale konsiderohet si një e drejtë e qytetarëve dhe një formë organizative e decentralizimit të pushtetit (neni 53 lidhur me nenin 176.1 i KSerb). KSerb që në fillim, në "Parimet e Kushtetutës", garanton të drejtën e qytetarëve për vetëqeverisje lokale, që flet shumë për rëndësinë e kësaj kategorie kushtetuese (neni 12.1 i KSerb). Si e tillë, ajo definohet si një e drejtë e qytetarëve me të cilën kufizohet pushteti shtetëror. Kjo nënkupton se vetëqeverisja lokale është e ndarë nga pushteti shtetëror dhe se bëhet fjalë për dy tërësi të veçanta. Tutje, e drejta për vetëqeverisje lokale i nënshtrohet vetëm kontrollit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, që nënkupton se vetëqeverisja lokale është aq e lirë sa pushteti qendror **nuk mund të kontrolloj oportunitetin e kryerjes së punëve lokale** (arsyeshmërinë e ndërmarrjes së një veprimi ose abstenimit nga ndërmarrja e tij nga ana e organeve lokale) (neni 12.2 i KSerb). Ky lloj kontrolli, **kontrolli i oportunitetit**, mund të bëhet vetëm sa i përket punëve të bartura (besuara) për kryerja në njësinë e vetëqeverisjes lokale nga ana e **Republikës së Serbisë** ose **Krahinës Autonome të Vojvodinës**, në kuptim të nenit 178 të **KSerb**. Kontrolli i oportunitetit është **kontroll profesional**, pra vetëm sa i përket mënyrës dhe cilësisë së kryerjes së punëve të bartura. Pra nëse punët janë kryer sipas udhëzimeve dhe porosisë së pushtetit sipëror që ka deleguar kryerjen e tyre (porositësi i punëve. Këtu komuna vepron sipas udhëzimeve, si një dorë e zgjatur e shtetit ose e administratës shtetërore. Kontrolli i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, ndërkaq, është **kontroll juridik**, i parapërcaktuar me norma juridike (kushtetuese dhe ligjore).[125] Sa i përket subjekteve, si **subjekte të së drejtës për vetëqeverisje lokale** konsiderohen krejt qytetarët e Serbisë, të radhitur, sipas vendbanimit të tyre, në komunitete lokale – **komuna**, **qytete** dhe në **qytetin e Beogradit** (neni 188.1 i **KSerb**).

Sa i përket **përmbajtjes së të drejtës për vetëqeverisje lokale**, ndërkaq, qytetarët në të gjitha komunat janë të barabartë, që nënkupton se njësitë e vetëqeverisjes lokale kanë kompetenca dhe organe të njëjta të pushtetit. Realizimi i mëvetësisë në komunë është e mundur për shkak se ajo mishëron **parimin e decentralizimit** që konkretizohet përmes disa cilësive të tij. Në rend të parë, vetëqeverisja lokale si formë e decentralizimit posedon një rreth të punëve të saj burimore, të cilat garantojhen me **KSerb** dhe më pas konkretizohen tutje me ligj. Një pjesë të tyre, vetëqeverisja lokale i kryen vetëm dhe vepron e vetme në tërësi. Në vetëqeverisje lokale, zgjedhja e organeve të njësisë vetëqeverisëse në tërësi është çështjee saj: qytetarët i zgjedhin organet e tyre të pushtetit, pa ndërhyrje të shtetit – **drejtpërdrejtë** kuvendin e komunës kurse **të rthorazi** kryetarin dhe këshillin e komunës. Shteti, vetëm më vonë, përmes gjykatës, nëse vjen deri të kontesti zgjedhor lidhur me ndonjë paligjshmëri, merr pjesë në procedurën zgjedhore. Vetëqeverisja lokale ka **burimet e përhershme të financimit**, si të ardhura vetjake me të cilat disponon lirshëm. Sa më të mëdha të jenë këto të hyra, aë me e realizuar do të jetë vetëqeverisja lokale. Përveç mëvetësisë në burime permanente financiare, Komuna ka edhe të **drejtën e posaçme të mbrojtjes**, të garantuar me KSerb, pranë mekanizmave për sa vijon: **GJKSerb**, **Gjykata Supreme e Serbisë** dhe **Gjykata Administrative e Serbisë**.

[125] Ky është një **standard përgjithësisht i pranuar evropian**, pra që kontrolli i oportunitetit të shtrihet vetëm ndaj punëve të bartura prej pushtetit sipëror, jo edhe ndaj punëve që bëjnë pjesë në juridiksionin burimor të vetëqeverisjes lokale. E njëjta vlen edhe për **Kosovën** dhe vendet tjera përreth. Cf. më shumë për këtë në kontekstin bavarian, por analizuar në aspektin juridiko-pozitivist dhe krahasimor, në Philipp C. Stiel. "Nadzor države nad jedinicama lokalne samouprave u Bavarskoj - samouprava, demokracija i pravna država - simbioza ili proturječnost?", *Hrvatska Javna Uprava*, god. 1 br. 2 (1999), fq. 303.-316 në fq. 308-310.

Nga diskutimi deri këtu, sikundër shihet, si një formë e decentralizimit e rregulluar me KSerb, vetëqeverisja lokale serbe ngërthen disa elemente të qenësishme, siç janë: emërtimi, territori, seli, themelimi dhe abrogimi i njësive të vetëqeverisjes lokale, mënyra e vendosjes së qytetarëve, rregullimi i organeve lokale, kompetencat, financimi, kontrolla dhe mbrojtja e vetëqeverisjes lokale.

Emërtimi i njësive të vetëqeverisjes lokale si: komuna, qyteti dhe qyteti i Beogradit, nuk nënkupton se ato janë lloje të ndryshme të komuniteteve lokale, por se bëhet fjalë për një njësi të të vetme themelore të vetëqeverisjes, përkatësisht për komunë, dhe dy njësi të tjera të prejardhura – qyteti dhe qyteti i Beogradit. Lidhur me territorin dhe selinë e vetëqeverisjes lokale vendos shteti me ligj, siç vendos për themelimin dhe abrogimin e saj. Kësaj, megjithatë, i paraprinë një **referendum lokal** që ka natyrë (karakter) konsultativ. Nga vetë organet komunale ose nga qytetarët mund të lind iniciativa për ndryshimin e kufijve komunal ose për themelimin e komunës së re.
Komuna, pra, ngelet njësia themelore në të cilën realizohet e drejta për vetëqeverisje lokale dhe konsiderohet si një bashkësi politike lokale me statusin e personit juridik, në territorin e të cilës jetojnë më së paku 10000 banorë. Përveç kësaj, komuna përfaqëson një tërësi administrative dhe ekonomike, e aftë për vetëqeverisje të cilën e realizon përmes organeve të veta dhe drejtëpërdrejtë nga ana qytetarëve.

Qytetet, për nga vëllimi juridik i vetëqeverisjes, janë thuajse të njëjtë me komunat, përveç emërtimit. Për dallim nga komunat, qyteti mund të organizoj punët e policisë komunale. Si njësi e vetëqeverisjes lokale, qyteti gjithashtu duhet të ketë së paku 10000 banorë, nganjëherë edhe më pak. Ai shërben si një qendër gravituese e administrative, ekonomike, kulturore dhe gjeografike. Qyteti ka të drejtë të formojë komunat e qytetit, në pajtim me statutin dhe kanë vetëm ato kompetenca që ua beson qyteti. Një status të posaçëm ka qyteti i **Beogradit**, të cilin **KSerb** e emërton si kryeqytet të Serbisë. Kryeqyteti është njësi e vetëqeverisjes lokale por krejt e posaçme. Kjo për shkak se përveç ligjit që ka të bëj me krejt komunat, posedon edhe një ligj të vetin që rregullon pozitën e kryeqytetit, sipas autorizimit shprehimor kushtetues. Komunat e qytetit të Beogradit kanë statusin e personit juridik. Kryqyteti, karahas kompetencave që ka komuna dhe qyteti, posedon edhe disa kompetenca të zgjeruara të përcaktuara me ligj, në sferën e punëve të inspektimit, veprimtarive komunale, mbrojtjes nga zjarri dhe të ngjashme.

Qarku dhe **bashkësia lokale** nuk kanë statusin e njësisë së vetëqeverisjes lokale. Tradicionalisht, në Serbi qarku apo rrethi ka qenë njësi e vetëqeverisjes lokale dhe bashkësi hibride shoqëroro-politike, kurse sot përfaqëson vetëm një formë të **dekoncentrimit të pushtetit**. Qarqet janë degë të ministrive jashtë selisë së tyre, pa asnjë kompetencë burimore, pavarësi organizative ose financiare. Përmes qarkut, administrata e shtetit është më afër qytetarit. Formohen me rregullore mbi qarqet administrative, bazuar në ligjin mbi administratën shtetërore. **Bashkësia lokale**, ndërkaq, është formë e organizimit në bazë të interesave të qytetarëve, të cilën e formon **kuvendi komunal** për një ose më shumë fshatra, vende të banuara, pjesë të qytetit, duke ia përcaktuar kompetencat, organizimin dhe punën e organeve. Edhe bashkësia lokale ka statusin e personit juridik, por kryen vetëm ato punë që ia ka besuar komuna. Në te mund të organizohet puna e administratës komunale dhe posedon me të ardhura burimore (vetëkontributi, donacionet) dhe të bartura.

Në njësinë e vetëqeverisjes lokale, qytetarët serb vendosin vetë ose përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur lirshëm. Format e vendosjes së drejtpërdrejtë janë: **iniciativa qytetare**, **referendumi lokal**, **tubimi i qytetarëve** dhe **zgjedhjet lokale**. Me **iniciativë qytetare**, kuvendit lokal i propozohet miratimi i ndonjë akti nga kompetenca e tij. Nëse iniciativën e kanë paraqitur së pakut pesë përqind e votuesve të komunës, procedura duhet të filloj detyrimisht. **Tubimi i qytetarëve** thirret për një pjesë të komunës, në mënyrë që organit lokal t'i parashtrohet petecioni për zgjidhjen e ndonjë çështjeje ose miratimin e ndonjë dispozite. **Peticioni** nuk detyron, por parashtruesit të tij organi lokal detyrohet t'i kthej një përgjigje. Vendosja reale e qytetarëve ndodh në **referendumin lokal**, në të cilin vendoset për çështjet me rëndësi lokale. Ai shpallet nga kuvendi lokal, me propozimin e së paku dhjetë përqind të votuesve. Zgjedhjet lokale konsistojnë në zgjedhjen nga votuesit të vetëm një organi të pushtetit, kuvendit komunal. Kushtet

për kandidim, procedura e zgjedhjeve, ndarjen e mandateve, mjetet juridike, krejt këto i normon **Republika e Serbisë** me ligj, kurse i zbaton komisionin komunal zgjedhor ose i qytetit. Qytetarët zgjedhin edhe anëtarët e këshillit të bashkësisë lokale.

Njësia e vetëqeverisjes lokale ka të drejtë të rregulloj në mënyrë të mëvetësishme organet dhe shërbimet lokale, në pajtim më KSerb dhe ligjin. Kjo e fundit nënkupton që shteti praktikisht rregullon organizimin e pushtetit lokal, kurse disa detaje dhe specifika i lë në kompetencë të vetëqeverisjes lokale. **Kuvendi i komunës** (ose i qytetit) është organi më i lartë lokal dhe i vetmi që ka **rangun e organit kushtetues**. Kuvendi miraton **statutin** si aktin më të lartë juridik të komunës dhe aktet tjera të përgjithshme, miraton buxhetin dhe llogarinë përfundimtare, planin e zhvillimit dhe planin hapësinor, shpall referendumin komunal dhe kryen punë të tjera të parapara me ligj dhe statut. Kuvendi zgjedh organet lokale ekzekutive: kryetarin dhe këshillin e komunës. Konfirmimin se kuvendi është organi më i lartë e gjejmë në dispozitat kushtetuese mbi këshilltarët që gjenden në KSerb. Krahas Kuvendit, KSerb përmend edhe organet ekzekutive, kurse organet tjera normohen me statut, në pajtim me ligjin (neni 180 lidhur me nenin 191 të **KSerb**).

Dispozitat më të shumta kushtetuese lidhur me vetëqeverisjen lokale kanë të bëjnë me kompetencat lokale. Njësitë e vetëqeverisjes lokale dallojnë mes veti deri diku vetëm në sferën e kompetencave që kanë. Qytetit, përveç kompetencave të dhëna me KSerb që kanë të bëjnë me komunën, me ligj mund t'i barten (besohen) edhe kompetenca të tjera (neni 189.3 i KSerb). Sa i përket qytetit të Beogradit, ai përmbledh kompetencat e qytetit dhe të komunës (neni 189.4 i KSerb).
KSerb i jep një mori kompetencash komunës, të cilat ajo i kryen përmes organeve të veta në pajtim me ligjin. Numri i kompetencave nuk kufizohet, për to përdoret shprehja se, "ajo kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj" (neni 180.1 nën pikën i KSerb). Kompetencat e komunës kanë të bëjnë me sa vijon: punët komunale, shfrytëzimin e tokës ndërtimore dhe hapësirës afariste, përkujdesja për rrugët lokale, objektet publike komunale, transportin lokal, arsimin, kulturën, mbrojtjen shëndetësore, sociale dhe të fëmijëve, sportin dhe kulturën fizike, turizmin, zejtarinë dhe hotelerinë, mbrojtjen nga fatkeqësitë elementare, tokën bujqësore (neni 190.1 i **KSerb**). Në të njëjtën nen numërohen edhe punët që komuna i kryen në mënyrë të pavarur dhe në pajtim me ligjin, punët që i kryen në pajtim me ligjin dhe, së fundi, punët që i kryen sipas autorizimit të drejtpërdrejtë kushtetues. Në grupin e parë hyjnë miratimi i buxhetit dhe planit përfundimtar, plani zhvillimor dhe urbanistik, konfirmimi i simboleve të komunës dhe përdorimit të tyre, dhe menaxhimi i pasurisë së komunës. Në grupin e dytë hyjnë punët e caktimit të kundërvajtjeve, në pajtim me ligjin, për cenimin e dispozitave komunale. Së fundit, në grupin e tretë, drejtpërdrejtë me mbështetje në KSerb, komuna ka të drejtë të përkujdeset për mbrojtjen dhe promovimin të drejtave të njeriut dhe të pakicave dhe për informimin publik në hapësirën komunale (neni 190.2 i KSerb).

Punët e besuara (bartura), kryesisht kanë të bëjnë me administratën shtetërore, ekzekutimin e ligjeve dhe të dispozitave të tjera juridike. Në këtë kuptim, komunës i besohen punët e inspektimit në fusha të ndryshme – arsimi, shëndeti, ambienti jetësor, xehetaria, bujqësia, pylltaria.

Siç u pa më sipër, komunat, njëjtë sikur në vendet tjera përreth Kosovës, kanë statusin e personit juridik, gjë që nënkupton se ajo realizon të ardhurat vetjake, planifikon shpenzimet dhe për këtë miraton buxhetin dhe llogarinë përfundimtare. Kjo është kështu për shkak se, mëvetësia financiare nënkupton të ardhura permanente dhe stabile, të cilat vetë i përcakton komuna dhe disponon me to. Kjo përcaktohet me **Ligji për financimin e vetëqeverisjes lokale**. Të ardhurat e komunës në Republikën e Serbisë, njëjtë si në vendet përreth Kosovës, janë të **natyrës burimore** dhe të **prejardhura**. Si të **ardhura burimore** janë të ardhurat që realizohen në territorin e komunës dhe hyjnë në buxhetin e saj, siç janë: taksat komunale, administrative dhe të vizitave, kompensimet për përdorimin e tokës ndërtimore të komunës, vetëkontributet. Komuna përcakton shkallën e këtyre të hyrave, si dhe parametrat dhe lartësinë e taksave dhe kompensimeve lokale. Komuna mund të hyj borxh, apo të marrë kredi, sipas kushteve të

tregut apo kushteve të volitshme, të subvencionuara, mund të lëshoj letra komunale me vlerë, bonot, për financimin e shpenzimeve vetjake. Aktin mbi marrjen e borxhit publik e miraton kuvendi komunal. Si të **ardhura të prejardhura** konsiderohen tatime shtetërore që janë mbledhur (realizuar) në territorin e komunës por për llogari të shtetit, të cilat më pastaj shteti në një përqindje të caktuar ose në tërësi ia kthen komunës. Të tilla janë: format e tatimit në të ardhurat e qytetarëve, siç janë: në fitim, nga veprimtaria e pavarur, të drejtat e autorit, tatimi në pasuri, tatimi në trashëgimi dhe dhuratë, tatimi në bartjen e të drejtave absolute. Një formë e posaçme është financimi i punëve, të besuara komunave për kryerje nga ana e Republikës ose **Krahinës Autonome të Vojvodinës**: në një rast të tillë, të gjitha shpenzimet mbulohen nga porositësi i kryerjes së punëve të tilla.

Sa i përket kontrollit të vetëqeverisjes lokale, **KSerb** autorizon pushtetin qendror për ushtrimin autorizimeve kontrolluese. Në këtë drejtim, as punët burimore, që kanë bazë dhe mbështetje të drejtpërdrejtë në **KSerb**, nuk mund të shmangen nga kontrolli. Qeveria mundet aktin më të lartë të komunës, statutin, ose vendimin e saj, ta ndaloj nga ekzekutimi nëse konsideron se ka problemeve me kushtetutshmërinë ose ligjshmërinë. Në mënyrë që ndalimi i ekzekutimit të jetë i vlefshëm, qeveria në afat prej pesë ditëve duhet të nis procedurën e kontrollit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së aktit të tillë (statutit ose vendimit të komunës). Mbi kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e aktit të kontestuar vendos GJKSerb. Qeveria ose organi tjetër shtetëror mund të iniciojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë së çfarëdo dispozite komunale, që përfaqëson një lloj kontrolli.

Qeveria, nën kushtet të caktuara me ligj, mund të **shpërndajë** kuvendin komunal. Kjo nënkupton që qeveria, në aspektin hierarkik, qëndron mbi kuvendin komunal, përkundër që bëhet fjalë për organet e dy pushteteve të ndryshme dhe në ndara-pushtetit të shtetit dhe pushtetit vendor. Njëkohësisht me shpërndarjen, qeveria bënë edhe emërimin e organin e përkohshëm, i cili, në periudhën kalimtare, punon në vend të kuvendit të shpërndarë e deri në zgjedhjen e kuvendit të ri komunal. Përbërja e organit kalimtar është e atillë që merret parasysh përbërja nacionale kuvendit të shpërndarë.

Mbrojtja e vetëqeverisjes lokale është e drejtuar në mënyrë të dyfishtë: si ndaj akteve të përgjithshme ashtu edhe ndaj atyre individuale me të cilat shkelet kompetenca komunale, përkatësisht e drejta për vetëqeverisje lokale. Komuna mund t'i drejtohet GJKSerb për mbrojtjen e të drejtave të veta. **Mbrojtja konkrete** ekziston kur kuvendi përmes organit të saj statutar (kuvendit komunal ose këshillit komunal), paraqet ankesë kushtetuese në GJKSerb, kur konsideron se me aktin ose veprimin individual të organit të shtetit ose organit të njësisë së vetëqeverisjes lokale pamundësohet ushtrimi i kompetencës komunale. **Mbrojtja e përgjithshme**, ndërkaq, konsiston në të drejtën e organit të komunës, kuvendit ose këshillit komunal, për të nisur procedurën për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së dispozitës republikane ose krahinore me të cilën shkelet e drejta e vetëqeverisjes lokale.

11.5.2. Organizimi i pushtetit të vetëqeverisjes lokale

Vetëqeverisja lokale në Serbi ka organet e veta sipas modelit të organeve shtetërore. Definimi, kompetencat dhe marrëdhënia mes veti e organeve të vetëqeverisjes lokale përcaktohet me **Ligji për vetëqeverisjen lokale.** Në këtë kuptim ka ngjashmëri të madhe me vendet tjera përreth Kosovës. Nga sistemi parlamentar në nivel të Serbisë, pushteti vendor dallon sepse përfaqëson sistemin e kuvendeve, mbi të gjitha për shkak të faktit që kuvendi i komunës paraqet organin më të lartë në nivel lokal. Krahas **kuvendit**, në komunë ekzistojnë edhe **kryetari i komunës**, **këshilli i komunës**, **administrata komunale**. Për një ose më shumë komuna mund të themelohet avokati i popullit, kurse në mjediset me përbërje nacionale të përzier, formohet një trup i posaçëm – **këshilli për marrëdhënie ndërnacionale**.

Kuvendi është organi më i lartë, karakteristikat themelore, kompetencat dhe përbërja normohen me KSerb, kurse më hollësisht përcaktohen me ligj. Kuvendi ka nga 19-75 këshilltarë, kuvendi i qytetit 90 këshilltarë, kurse kryeqyteti serb (Beogradi) – 110 këshilltarë. Kuvendi quhet i **konstituuar** me

zgjedhjen e kryetarit të kuvendit dhe caktimin e sekretarit të kuvendit, i cili udhëheq me administratën e kuvendit. Nga kjo ditë nis të rrjedhë **mandati katërvjeçar**. Ky mandat është më i shkurtër, nëse Qeveria shpërndan kuvendin për shkak se nuk është mbledhur më gjatë se tre muaj, nuk zgjedh kryetarin dhe këshillin komunal (afati është një muaj), nuk miraton statutin ose buxhetin e komunës. Kuvendi vendos në mënyrë publike, me shumicën e votave të këshilltarëve prezent, me kusht që në mbledhje marrin pjesë shumica nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve. Me kuvend kryesor dhe udhëheq kryetari, kurse në rast mungese ose pengesës për të marrë pjesë, atë e zëvendëson zëvendësi kryetarit të komunës. Këshilltarët gëzojnë **imunitet material**, që do të thotë se nuk janë përgjegjës penalisht për mendimin dhe votën e dhënë në kuvend.

Sipas **KSerb**, ligjit dhe statutit, në pajtim më rregulloren e punës së kuvendit (RoP), kuvendi ka dhe ushtron një numër kompetencash. Kompetenca e tij **normative** përbëhet nga sa vijon: miratimi i statutit, buxhetit dhe llogarisë përfundimtare, programin e zhvillimit, planit urbanistik, dispozitave, vendimeve dhe akteve të tjera të përgjithshme. Në këtë aktivitet normativ hyjnë edhe vendimet për taksat komunale, kompensimet, borxhin publik. Në **të drejtat zgjedhore dhe të drejtat e themelimit** të kuvendit hyjnë sa vijon: zgjedhja dhe shkarkimi i **kryetarit të komunës** dhe zëvendësit të tij, e anëtarëve të këshillit komunal, avokatit lokal të popullit, si dhe zgjedhja e **udhëheqësisë së kuvendit**, kryetarit, zëvendësit dhe sekretarit, si dhe trupave punës të kuvendit, të përhershëm dhe të përkohshëm. Komuna forma shërbime, ndërmarrje, institucione dhe organizata publike, zgjedh dhe shkarkon funksionarët e tyre (drejtorët) dhe kryen mbikëqyrjen e punës së tyre, formon shtabin komunal për situatat e jashtëzakonshme, komisionin komunal zgjedhor. **Autorizimet kontrolluese të kuvendit** kanë të bëjnë me marrëdhëniet me kryetarin dhe këshillin komunal. Këto organe rregullisht informojnë kuvendin për punën e tyre dhe mund të shkarkohen. Me shkarkimin e kryetarit të komunës, me shumicën e këshilltarëve nga numri i tërësishëm i anëtarëve të kuvendit, përfundon edhe mandati i zëvendësit dhe këshillit komunal. Kuvendi mund të shkarkoj edhe anëtarin individual të këshillit komunal. Ndryshe nga kjo, **organi ekzekutiv i komunës** nuk mund të **shpërndajë** kuvendin. Kuvendi komunal ka edhe **autorizime të posaçme**, të cilat kanë të bëjnë me sa vijon: shpallja e referendumit komunal, dhënia e mendimit për planet hapësinore republikane dhe për planet tjera hapësinore, dhënia e mendimit për ligjet që kanë të bëjnë me vetëqeverisjen lokale, vënia në lëvizje e procedurës për kontroll të kushtetutshmërisë së ligjeve pranë GJKSerb, dhënia e pëlqimit mbi përdorimin e emrit dhe emblemës së komunës, lidhja e marrëveshjeve me **vetëqeverisjet lokale të shteteve të tjera**, sipas pajtimit paraprak të Qeverisë dhe kështu me radhë.

Kryetari i komunës është organ ekzekutiv i komunës dhe kjo vlen edhe për prefektin e qytetit në qytet. E zgjedhë kuvendi i komunës nga radha e këshilltarëve komunal, së bashku me zëvendësin e saj/tij, me propozimin e kryetarit të kuvendit, me votim të fshehtë. Për t'u zgjedhur kryetari i komunës kërkohen votat pro të shumicës së anëtarëve të kuvendit komunal, me mandat që zgjatë katër vite. Me rastin e zgjedhjes, i pushon mandati i këshilltarit **ipso iure**. Zgjedhja e tërthortë vetëm pjesërisht dobëson pozitën e saj/tij, sepse deri sa gëzon besimin e shumicës së këshilltarëve komunal, ajo/ai realisht udhëheq me komunën. Qëndron në funksion tërë kohën që gëzon besimin e kuvendit komunal, në të kundërtën mund të shkarkohet me shumicën e njëjtë me të cilën është zgjedhur, sipas propozimit të së pakut një të tretës së këshilltarëve. Si bartës i **funksionit ekzekutiv**, kryetari i komunës **ka dy cilësi**: e para, ajo/ai është kryetar i këshillit komunal, të cilin e përfaqëson, drejton, thirr mbledhjen e tij, përgjigjet për ligjshmërinë e punës së tij dhe mund të ndaloj zbatimin e vendimit të tij; dhe, e dyta, kryetari i komunës është organ inokos dhe përfaqëson komunën. Kompetencat e tij kanë të bëjnë lidhur me propozimin e mënyrës së zgjidhjes së ndonjë çështjeje në komunë, ekzekutimin e buxhetit të komunës, drejtimin dhe harmonizimin e administratës komunale, sjelljen e akteve individuale në vijim të ushtrimit të këtyre autorizimeve dhe kështu me radhë.

Këshilli komunal është organi i dytë ekzekutiv, i cili, në të vërtetë, së bashku me kryetarin e komunës përfaqësojnë tërësinë unike të funksionit ekzekutiv në komunë. Anëtarët e këshillit komunal zgjidhen

në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën mënyrë me kryetarin e komunës, më një dallim që këta propozohen nga kandidati për kryetar të komunës dhe nuk duhet domosdo të jenë nga radhët e këshilltarëve komunal. Atyre këshilltarëve që zgjidhen në këshillin komunal, u ndërpritet mandati si këshilltarë. Ky organ mund të ketë më së shumti 11 anëtarë (Beogradi deri në 13 anëtarë), përfshirë zëvendësin e këshillit që hyn aty sipas funksionit. Anëtarët individual të këshillit mund të shkarkohen, sipas mënyrës që janë zgjedhur – me propozimin e kryetarit të komunës ose një të tretës së këshilltarëve. Këshilli vendos me shumicën e anëtarëve prezentë, nëse është prezent shumica e krejt anëtarëve të tij. Ky organ propozon statutin dhe aktet tjera të përgjithshme kuvendit dhe kujdeset për zbatimin e tyre, sjell vendimin për financimin e përkohshëm nëse kuvendi refuzon (nuk voton) propozimin e buxhetit, mbikëqyrë punën e administratës komunale, vendos në shkallë të dytë në procedurën administrative, kujdeset për zbatimin e punëve të deleguara (bartura) nga pushteti qendror dhe ai i Krahinës Autonome të Vojvodinës, cakton dhe shkarkon eprorët e administratës komunale, vendos për konfliktin për kompetencë në nivel lokal.

Administrata komunale nuk është shërbim profesional por një organ i posaçëm lokal që drejtohet nga drejtori. Në komunat më të mëdha (me mbi 50000 banorë), mund të ekzistojnë administrata komunale për lëmi të caktuara, në kuadër të administratës unike komunale, me në krye drejtorin. Për lëmit e caktuara, si funksionarë të administratës komunale mund të vihet ndihmësit e kryetarit të komunës. Administrata komunale zbaton vendimet dhe aktet tjera të kuvendit dhe organeve ekzekutive, ushtron mbikëqyrje, vendos në procedurën administrative, ekzekuton ligjet kur një gjë e tillë i besohet, përgatitë draftet e dispozitave lokale, kryen punë profesionale dhe punë të tjera.

Në njësinë e vetëqeverisjes lokale në Serbi mund të themelohet **zyra e avokatit të popullit**, që quhet "mbrojtësi i qytetarëve" ("zastitnik gradjana"), si një organ i pavarur lokal, i cili ka autorizim për kontroll të administratës komunale dhe shërbimet publike në lidhje me shkeljet eventuale të lirive dhe të drejtave të njeriut. Ky organ themelohet me statut (i pari i këtij lloji është themeluar në Suboticë të Vojvodinës në vitin 2002), me të cilin, me vendim të kuvendit, rregullohet statusi i tij juridik.

Si një trup i veçantë punues në vetëqeverisjet lokale me popullsi të përzier në pikëpamje nacionale formohet **Këshilli për marrëdhëniet ndërnacionale**. Ky organ ka përbërje në bazë pariteti, sepse në te janë përfaqësuar në mënyrë të barabartë përfaqësuesit e pakicave kombëtare dhe përfaqësuesit e popullit serb. Në këtë këshill shqyrtohen çështjet dhe jepen mendimet për të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me barazinë nacionale në nivel lokal. Sipas ligjit, Këshilli mund të vej në lëvizje procedurën për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë aktit të përgjithshëm lokal para GJKSerb dhe atë në lidhje me shkeljen (cenimin) e të drejtave e anëtarëve të pakicave kombëtare dhe pjesëtarëve të popullit serb. Kjo përcaktohet me ligjin që rregullon punën e këtij organi, jo me **KSerb**: Këshilli nuk është ndër subjektet e autorizuara kushtetuese për vënien në lëvizje të procedurave për kontrollin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë.

12. Komente dhe pyetje

12.1. Përgjigjja në pyetjen së çfarë rregullimi shtetëror i duhet një vendi varet nga disa faktorë, të cilët nuk kanë natyrën e **faktorëve juridiko-kushtetues**. Për çfarë bëhet fjalë këtu?

12.2. Mbi një territor shtetëror mund të ekzistojnë disa mënyra të organizimit të marrëdhënieve mes radhëve të ndryshme territoriale, mes pushtetit qendror dhe kolektiviteteve infra-shtetërore, mes qendrës dhe periferisë. Pushteti i vendimmarrjes, pushteti normativ, me fjalë të tjera, mund të jetë i ndarë sipas **modelit unitar** dhe sipas **modelit pluralist**. Diskutoni!

12.3. Çka nënkuptohet me modelin pluralist të shtetit dhe çfarë dallon ai nga modeli unitar?

12.4. Sipas cilit kriter dallohen organet shtetërore nga organet tjera që ekzistojnë në nivel të njësive federale, të autonomisë dhe regjionit?

12.5. Dy janë **format themelore të rregullimit shtetëror**, të ndërtuara mbi bazën e ndarjes vertikale

të pushtetit, të cilat dallohen për nga karakteristikat e tyre të dallueshme reciprokisht – **shteti unitar** (ose i thjeshtë) dhe **shteti federal** (ose i përbërë). Diskutoni dallimet mes tyre!

12.6. Forma përmes së cilës shteti unitar i afrohet shtetit federal është trajta e **shtetit unitar të decentralizuar**. Pse?

12.7. Si formë e posaçme e shtetit unitar mund të konsiderohet edhe **unioni i bashkuar**, që është një formë e rregullimit shtetëror në të cilin ekzistojnë më shumë ligjvënës, jo vetëm një. Për cilin shtet bëhet fjalë dhe pse?

12.8. **Shteti regjional**, formë e veçantë e rregullimit shtetëror, nuk është në tërësi i ndarë nga karakteristikat që posedojnë dy format si më sipër – shteti unitar dhe shteti i përbërë. Diskutoni!

12.9. Formimit të **shtetit regjional**, si një zgjidhje kushtetuese, i kanë parapri krijimi i rrethanave specifike historike dhe politike në dy vendet ku ai u krijua, në **Itali** (1948) dhe **Spanjës** (1978). Kjo formë është kategori e veçantë e rregullimit shtetëror për aq sa dallon nga decentralizimi substancial në një shtet unitar dhe federalizimi, si dy forma të dallueshme në çdo rast. Arsyet për regjionalizim të shtetit janë të ngjashme me ato që lidhen me formimin e federatave, por kushtet politike janë të tilla që nuk prodhojnë pëlqim për federalizim të shtetit. Diskutoni arsyet!

12.10. Nëse njësia lokale gëzon një pavarësi politike, atëherë ajo quhet **vetëqeverisje lokale**. Çfarë nënkupton kjo?

12.11. Çka është **shteti unitar** dhe cilat janë cilësitë e tij?

12.12. Cili është roli dhe pozita kushtetuese e **organeve joqendrore** në shtetin unitar?

12.13. Çfarë nënkuptohet me konceptin e **prezumimit të kompetencës** në një shtet unitar dhe si manifestohet ky prezumim?

12.14. Është e qartë se **organet joqendrore** nuk mund të kryejnë punë që bien në domenin ekskluziv të punëve shtetërore. Cilat janë ato?

12.15. Kriteri themelor sipas të cilit dallohen **punët burimore** dhe **punët e besuara** (bartura, deleguara) të **organeve joqendrore** ka të bëjë me **natyrën materiale** dhe **natyrën formale** të punëve në fjalë, pastaj me **regjimin juridik të kontrollit**. Diskutoni!

12.16. **Objekt kontrolli** i punëve burimore të organeve joqendrore është **ligjshmëria** e kryerjes së tyre. Pse?

12.17. **Punët e besuara** pushteti qendror zakonisht i bartë me ligj (i delegon) të organet joqendrore. Pse kjo është kështu dhe për cilat punë bëhet fjalë?

12.18. Në ndarjen e punëve në shtetin unitar mund të dominojë **parimi i decentralizimit** ose **parimi i dekoncentrimit**. Cili është dallimi mes tyre?

12.19. **Ndryshimet në pushtetin ligjvënës** janë ilustrimi më i mirë i **shtetit të decentralizuar**. Në **dy pushtetet tjera**, zakonisht nuk ilustrohen format e decentralizimit të shtetit. Çfarë do të thotë kjo?

12.20. Kryerja e punëve **jashtë qendrës** mund të organizohet sipas sistemit të **vijës njëkahëshe** dhe **vijës dykahëshe**. Diskutoni!

12.21. **Centralizimi** ose **unitarizimi** është një proces i kundërt me procesin e decentralizimit. Çka dallon ky koncept nga **dekoncentrimi**?

12.22. Si krijohet **unioni personal**?

12.23. Sot union personal mund të quhet **Komonveliti i Kombeve** (“Commonwealth of Nations”), i formuar nën kurorën britanike. Pse?

12.24. Çka është **unioni real** dhe cilat punë i kryer ai në emër dhe për interes të anëtarëve të unionit?

12.25. Tregoni cilësitë e unionit real me disa shembuj konkret, duke bërë dallimin mes unionit real klasik dhe atij që themelohet për fusha specifike konkrete!

12.26. Çka është **konfederata** dhe çfarë ngjashmërie ka me BE-në?

12.27. Kush është bartës i sovranitetit në **konfederatë** dhe kush e ka pushtetin sovran?

12.28. A vlen për konfederatën **parimi i integritetit territorial**, apo vetëm për shtetet anëtare?

12.29. Përkundër që konfederata nuk është shtet por lidhje e shteteve sovrane dhe të pavarura, ajo megjithatë ka disa cilësi të shtetit. Diskutoni!

12.30. Konfederata nuk ka **kushtetutë**, nuk ka organe të pushtetit (ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor), por ka organe që në emër të saj dhe në emër të shteteve anëtare kryejnë punët e caktuara, të cilat zakonisht kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe raportin me shtetet tjera në të drejtën ndërkombëtare. Diskutoni!

12.31. **Konfederatat** lindin në atë mënyrë që shtetet bashkohen në një aleancë me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së përbashkët nga shtetet e treta. Diskutoni me shembuj konkret!

12.32. Federata ka anët pozitive dhe anët negative. Diskutoni, duke u bazuar në shembuj praktik!

12.33. Pse SHBA cilësohet si "kazani shkrirjes" ("melting pot")?

12.34. Cilat janë arsyet për themelimin e federatave?

12.35. Përbërja **shumënacionale** e popullsisë në një shtet konsiderohet si njëri ndër arsyet kryesore për themelimin e shtetit me rregullim federal. Diskutoni!

12.36. Në lindjen e federatës mund të hetohen **faktorë të ndryshëm historik**.

12.37. **Arsyet gjeografike** gjithashtu ndikojnë në krijimin e federatave, përkatësisht të disa prej njësive federale. Diskutoni!

12.38. **Arsyet ekonomike** nuk janë mbizotërues në krijimin e federatave, por përfaqësojnë në rend të parë një shkak të vlefshëm në themelimin e **unioneve reale**. Diskutoni!

12.39. Arsyet dhe shkaqet për federalizim të shteteve veprojnë së bashku, apo në mënyrë individuale, secili prej tyre i izoluar dhe në vetvete paraqet një arsye të vetme për themelimin e një federate?

12.40. Federatat mund të **grupohen në disa grupe**, sipas disa kritereve. Cilat janë ato kritere?

12.41. Sipas **mënyrës së krijimit** dallojmë federatat që krijohen me **agregacion** dhe ato që krijohen me **devolucion**. Diskutoni!

12.42. **Devolucioni** është proces i kundërt gjatë themelimit të federatës. Diskutoni!

12.43. Sipas **përbërjes së tyre nacionale**, federatat e ndajmë në **shumënacionale** dhe **njënacionale** (homogjene). Diskutoni!

12.44. Sipas **parametrave juridikë**, federatat paraqiten me **strukturë të ndryshueshme** ose **të pandryshueshme**, janë me **përbërje të thjeshtë** ose **me strukturë të përbërë. Diskutoni**

12.45. Cili është rregulli sa i përket statusit juridiko-kushtetues të njësive federale? Cilat janë përjashtimet?

12.46. Sipas kualitetit dhe ekzistimit ose jo të sovranitetit, dallohen federatat e krijuara me **devolucion** në raport me ato të krijuara me **agregacion**. Diskutoni!

12.47. Çfarë nënkupton pluraliteti i kushtetutave në federatë dhe kush është akti suprem juridik në nivel të federatës? Diskutoni!

12.48. Kur në federatë ekzistojnë "më shumë akte juridike supreme", thënë kushtimisht, atëherë fuqia sipërore juridike e kushtetutës federale ndiqet nga epërsia absolute e ligjeve federale kundrejt ligjeve të njësive federale. Pse?

12.49. Sistemi juridik në federatë është më i ndërlikuar se sistemi juridik në një shtet unitar, me vet faktin që në te ekzistojnë më shumë kushtetutëbërës dhe ligjvënës, në nivel të federatës dhe të njësive federale. Çfarë relevance ka kjo për sistemin juridik të federatës?

12.50. Përjashtimisht, në shtetet federale mund të ekzistojnë **e drejta për shtetësi të dyfishtë** (që i ofron me konfederatat), ku qytetarët kanë shtetësinë e njësisë federale dhe të federatës, në të njëjtën kohë. Kështu ka qenë në **Jugosllavinë komuniste**. Çfarë efekti ka pasur kjo shtetësi në planin e jashtëm?

12.51. Njësitë federale kanë statusin e personit juridik në të drejtën e brendshme, por mund të posedojnë edhe cilësi të caktuara të pjesshme juridiko-ndërkombëtare. Subjektiviteti i tyre në të drejtën ndërkombëtare është i kufizuar dhe ka të bëj me fushat e caktuara. Çfarë do të thotë kjo?

12.52. Ndarja vertikale e pushtetit nuk përfundon në njësi federale, por lëshohet teposhtë, deri në nivel të vetëqeverisjen lokale, kurse përcaktimi i kompetencave me kushtetutë bëhet vetëm sa i përket federatës dhe njësive federale, vetëm sa i përket materies së punëve dhe çështjeve shtetërore. Diskutoni!

12.53. Kompetenca burimore e federatës vlen për të gjitha degët e pushtetit. Diskutoni pse kjo është kështu dhe për cilat **kompetenca burimore** bëhet fjalë!

12.54. Të ndarja e juridiksionit dhe kompetencës mes federatës dhe njësive federale dallohen **tri grupe**. Diskutoni!

12.55. Juridiksioni dhe kompetenca e federatës dhe njësisë federale mund të ndahen edhe sipas kriterit të **juridiksionit dhe kompetencës së supozuar**. Çfarë nënkupton kjo?

12.56. Për dallim nga shteti unitar, bashkësitë politike në federatë marrin pjesë në formimin e organeve të federatës. Diskutoni!

12.57. Cila është rëndësia e **parimit të shumicës** në një federatë?

12.58. Parimi i **përfaqësimit të barabartë** të njësive federale në **dhomën e sipërme** shpreh parimin e barazisë absolute të njësive federale. Çka nënkupton kjo?

12.59. **Federata** aktualisht përfaqëson formën me të zhvilluar të decentralizimit, "megadecentralizim", që në të njëjtën kohë është edhe formë funksionale. Statusi i njësive federale nuk është i njëjtë në të gjitha federatat, nganjëherë dallojnë në status edhe brenda vetë shtetit të njëjtë. Disa karakteristika të statusit të tyre, megjithatë, mund të dallohen. Diskutoni këto karakteristika të statusit të tyre juridiko-kushtetues!

12.60. Quhen **regjionale** ato shtete që kanë formën e rregullimit shtetëror **mes federatës dhe shtetit unitar**. Çfarë do të thotë kjo!

12.61. Cilat janë cilësitë apo karakteristikat themelore të **shtetit regjional**?

12.62. Kushtetutat e **Italisë** dhe **Spanjës**, në një masë të madhe (Italia) ose më të vogël (Spanja), kanë lënë prapa rregullimin e vjetër shtetëror, duke bërë një hap të përpara dhe vendimtar në drejtim të demokratizimit në raport me regjimet e vjetra dhe të degraduara. Diskutoni!

12.63. Brenda shtetit mund të dallohen **tri koncepte të decentralizimit**, nga të cilat vetëm njëri ka natyrë juridiko-kushtetuese. Për cilin koncept bëhet fjalë?

12.64. Arsyet për krijimin e regjioneve si njësi të veçanta politiko-territoriale janë të ngjashme me arsyet e krijimit të njësive federale. Çka nënkupton kjo ?

12.65. Organizimi i pushtetit në regjion përfshinë organet si vijon: **organin përfaqësues**, që qëndron kundruall parlamentit nacional brenda shtetit, pastaj **organet që kanë funksionin e ekzekutivit**, ngjashëm me qeverinë, dhe **organet regjionale të administratës**. A kanë regjionet gjykatat e tyre vetjake regjionale?

12.66. Sa i përket financimit të organeve të pushtetit dhe të punëve, synim parësor është që regjioni të ruhet si **një tërësi e qëndrueshme ekonomike**. Diskutoni!

12.67. Pse është e domosdoshme **mbrojtja e vetëqeverisjes regjionale** dhe cilat janë instrumentet juridike të mbrojtjes?

12.68. Në parim, regjionet nuk marrin pjesë në miratimin dhe amendamentimin e kushtetutës nacionale. Nëse bëhet fjalë për procedurën e ndryshimit të territorit, gjerat ndryshojnë, qoftë kur flitet për zvogëlimin, rritjen bashkimin e regjioneve ose ndarjen e tij në disa regjione. Diskutoni!

12.69. Themelimi i komunave të reja në Kosovë në vitet 2002-2008, përkundër numrit të madh të tyre, nuk ka arritur të prish karakterin unitar të **shtetit të Kosovës**, i cili, deri në momentin e shkruarjes së këtyre rreshtave (prill 2023), vazhdon të ngelet shtet unitar me decentralizim të theksuar të nivelit komunal. Kjo gjendje, megjithatë, ka nisur të vihet në dyshim me **MA 2013**, e operacionalizuar me **MA 2015**, përfundimisht e ngritur në nivel të detyrimit **super-kushtetues** me **MO** të datës 18 mars 2023, e cila ka futur të gjitha detyrimet ndërkombëtare të Kosovës lidhur me pozitën specifike dhe të veçantë të serbëve lokal, kishave dhe trashëgimisë së tyre kulturore, nën **ombrellën juridike** (nën regjimin juridik-kushtetues) të **BE-së.** Diskutoni!

12.70. Për implementimin e **MO** përkujdeset vetë BE, e cila, për dallim nga MA 2013 dhe MA 2015, ka krijuar një komitet të përbashkët (neni 10 i **MO** lidhur me pikën 6 të **Planit të Zbatimit** të **MO**). Diskutoni!

12.71. **MO** dhe **Plani i Zbatimit** nuk janë marrëveshja e fundit për normalizim të marrëdhënieve mes dy vendeve, aq më pak ndonjë **njohje de jure** ose **njohje de fakto** e Kosovës. Pse?

12.72. Në vijim si më sipër, pyetja që shtrohet është kjo: cili është statusi juridik i MA 2013 dhe MA 2015? Pa asnjë dyshim, ky status duhet vlerësuar në dritën e nenit 10.2 të **MO**, i cili përcakton si vijon: "Palët konfirmojnë detyrimin për të zbatuar të gjitha marrëveshjet e prodhuara nga

dialogu i kaluar, të cilat ngelin të vlefshme dhe të detyrueshme". Çka nënkupton kjo?

12.73. Brenda autonomisë joterritoriale janë kristalizuar tri forma standarde: **autonomia tradicionale joterritoriale**, **autonomia administrative joterritoriale** dhe **autonomia funksionale joterritoriale**. Tregoni dallimet mes tyre dhe vendin e autonomisë së serbëve lokal në Kosovë?

12.74. Pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912, menjëherë është shtruar çështja e formës së që do të ketë shteti shqiptar. Cili ka qenë propozimi i Ismail Qemalit lidhur me këtë?

12.75. A ekziston një nivel i ndërmjetëm i pushtetit në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe në Mal të Zi? Cila është forma themelore e decentralizimit në këto vende? A ekzistojnë regjionet në Serbi?

12.76. Në aspektin përmbajtësor, ndërkaq, autonomia nënkupton atë nivel të pushtetit në të cilin krijohen ligje. Kjo e bën qartë të dallueshëm si kuptim përmbajtësor nga vetëqeverisja lokale. Pse?

12.77. Në aspektin teorik dhe praktik, më i vështirë është dallimi mes njësisë së autonomisë territoriale dhe njësisë federale, e cila gjithashtu nxjerr ligje. Pse?

12.78. Pse shteti ka të drejtën e kontrollit kushtetues të ligjeve që nxjerr njësia e autonomisë territoriale, të drejtën e vlerësimit të ligjshmërisë së akteve nënligjore që nxirren me qëllim të zbatimit të ligjeve të shtetit, dhe mund të ketë edhe të drejtën e kontrollit të oportunitetit të dispozitave që i ka nxjerrë vetë autonomia territoriale (nëse nxjerrja e tyre ka qenë me vend ose jo)?

12.79. **Kërkesat politike për autonomi**, ndërkaq, rrjedhin nga shkaqet që ekskluzivisht lidhen me popullsinë e territorit. Diskutoni!

12.80. Përvoja tregon se edhe atëherë kur ekzistojnë arsyet e mira për themelim të **autonomisë territoriale**, jo me shumë vullnet shtetet pranojnë një gjë të tillë. Në vend të kësaj, shtetet iu janë qasur më shumë formave të buta të përmbajtjeve të autonomisë, të cilat nuk përfshijnë vendimmarrjen politike. Në këtë mënyrë, dallohen **autonomitë kulturore**, **institucionale** dhe **ekonomike**. Përmbajtja e formave të këtyre autonomive përcaktohet me aktet juridike të organeve qendrore, si dhe me akte autonome, që nuk përfshijnë të drejta politike. Diskutoni!

12.81. Autonomia territoriale është kategori kushtetuese dhe ligjore. E tillë mund të jetë edhe **autonomia joterritoriale**, por vetëm në disa format e saj të manifestimit, për aq sa kjo ka të bëj me **regjionalizëm politik** brenda shtetit (pra kur regjionet e caktuara, në trajtë **asimetrike** ose **simetrike**, ose dyja së bashku, përfaqësojnë nivelin e ndërmjetëm të pushtetit; Italia dhe Spanja, janë shembuj tipik të kësaj forme shtetërore). Diskutoni autonominë territoriale si kategori kushtetuese dhe ligjore, duke u fokusuar në gjetjen e përgjigjes në pyetjen se përse autonomia territoriale është kategori kushtetuese e përse kategori ligjore?

12.82. Vartësia ndaj pushtetit shtetëror dhe ligjeve të tij flet mjaftueshëm për statusin juridiko-kushtetues të autonomisë territoriale dhe për fuqinë juridike të dispozitave të saj. Çfarë do të thotë kjo në raport me **statusin juridiko-kushtetues** të autonomisë dhe në raport me **hierarkinë e akteve juridike** të akteve të autonomisë?

12.83. Rendin juridik të autonomisë e përbën **statuti**, një emër i përbashkët për aktin më të lartë juridik të autonomisë, ligji (në rastet kur autonomia ka juridiksion ligjvënës) dhe dispozitat nënligjore. Në aspektin juridik-krahasimor, aktet më të larta të autonomive territoriale kanë fuqi të ndryshme juridike. Diskutoni!

12.84. Për dallim nga njësia federale, autonomia territoriale nuk ka veçoritë e shtetit, apo i ka në një masë shumë më të vogël dhe vetëm sa i përket ndonjërit prej elementeve të tij individuale. Çfarë do të thotë kjo?

12.85. Për dallim nga njësia federale, **nuk është e përfaqësuar në mënyrë të veçantë në parlamentin nacional**. Çfarë do të thotë kjo?

12.86. Autonomitë territoriale formohen në shtetet unitare për arsye të njëjta që formohen njësitë federale në federata. Në mesin e këtyre arsyeve dominojnë ata etnik, historik dhe gjeografik. Përjashtimisht, autonomitë territoriale ekzistojnë edhe në federata (**Federata Rusisë**, **India**). Cilësia themelore e shteteve me autonomi territoriale konsiston në atë se ato **janë asimetrike në aspektin territorial.** Çfarë do të thotë kjo?

12.87. Përveç faktit që janë **asimetrike në aspektin territorial**, autonomitë territoriale kanë edhe

disa karakteristika të tjera më përmbajtësore. Cilat janë ato?

12.88. **Autonomia territoriale**, në rend të parë, nënkupton **vendimmarrje politike,** brenda së cilës hyn edhe **nxjerrja e ligjeve**. Në aspektin teorik, autonomitë e pastra territoriale me vetëqeverisje politike, nuk mund të ekzistojnë pa kompetencën në ligjvënie. Format ideale teorike, megjithatë, vështirë hasen në realitetin jetësor. Ato që ekzistojnë, sipas karakteristikave të tyre, dallojnë nga format ideale kryesisht në **dy drejtime**. Çfarë do të thotë kjo?

12.89. Një karakteristikë tjetër e rëndësishme e autonomisë territoriale është se ajo ka formë të njëjtë të qeverisjes, përkatësisht të rregullimit shtetëror dhe të pushtetit shtetëror, sikur shteti pjesë e të cilit është. Sistemi parlamentar që ka shteti, megjithatë, në autonomitë territoriale mund të jetë më i ndryshëm. Me çfarë ngjason sistemi përfaqësimit në autonomi territoriale, me cilin sistem të pushtetit?

12.90. A merr pjesë **autonomia territoriale** në formimin e vullnetit politik në shtet?

12.91. A ka **autonomia territoriale** përfaqësuesit e saj në pushtetin ekzekutiv?

12.92. Autonomia territoriale gëzon **pavarësi të kombinuar** me të drejtat e pushtetit qendror, i cili garanton, kontrollon dhe ngushton vetëqeverisjen e saj. Si shprehen këto ingerenca të pushtetit qendror kundrejt autonomisë territoriale?

12.93. Në momentin e shkrimit të këtyre rreshtave (22 prill 2023), akoma nuk dihen qartë përmasat e autonomitetit serb në Kosovë. Ajo që dihet është kjo: autonomia e tyre nuk është qëllim përfundimtar i Serbisë, por një mjet për arritjen e qëllimeve të tjera – restaurimin e sovranitetit serb në Kosovë. Përveç kësaj, qartë dihet se, siç e pamë më sipër, më shumë ka gjasë që Kosova të shkoj kah një lloj shteti me **decentralizim asimetrik**, i fortë dhe në favor ekskluziv të komunitetit serb, diçka që seriozisht rrezikon kohezivitetin shoqëror dhe diskriminon komunitetet tjera. Ajo që shohim duke u shpalosur është niveli më i lartë i **decentralizimit asimetrik** në favor të një komuniteti etnik dhe fetar – serbëve. Cilat janë dy komponentët nga të cilat përbëhet ky decentralizim asimetrik?

12.94. Komponenti i **autonomisë jo-territoriale** të komunitetit serb, me të drejtën e tij për **vetëmenaxhim të plotë** të punëve që kanë të bëjnë me te, përfaqëson një model të ngjashëm me **sistemin e kapitulacioneve** në ish-**Perandorinë Osmane** dhe në disa perandori aziatike në të kaluarën. Diskutoni!

12.95. **Maqedonia Veriut** është shtet unitar dhe i decentralizuar. Në historinë më të re të këtij vendi, pas pavarësimit të tij, ka pasur përpjekje të shqiptarëve për krijimin e një territori autonom, i njohur si ”Ilirida”, por pa sukses. Autoritetet maqedonase e panë këtë si një ”Kali të Trojës” dhe e refuzuan me forcë. Pozita e shqiptarëve në këtë vend u përmirësua vetëm pas luftës së armatosur të **Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare** (**UÇK**) kundër forcave të ushtrisë dhe policisë si dhe forcave paramilitare në **Maqedoninë e Veriut** dhe arritjes së **Marrëveshjes së Ohrit** (2001). Diskutoni!

12.96. Bazuar në **KSerb**, Serbia hyn në radhën e shteteve unitare të decentralizuara me autonomi territoriale, i vetmi vend fqinj me Kosovën që posedon diçka të tillë. Diskutoni!

12.97. Me nenin 12 të **KSerb**, e drejta për krahinë autonome definohet si një e drejtë e qytetarëve me të cilën kufizohet pushtetit shtetëror. Të drejtën për autonomi territoriale qytetarët e realizojnë **në mënyrë të drejtpërdrejtë**. Cilat janë mënyrat në fjalë?

12.98. Krahina autonome në Serbi miraton aktet e saj të përgjithshme. A ka **ka kompetencë ligjvënëse**?

12.99. Çka nënkuptohet me vetëqeverisje lokale dhe kush e ka përdorur për herë të parë këtë shprehje?

12.100. Ku nis për herë të parë pranimi i vetëqeverisjes lokale dhe pse?

12.101. Shteti ndan **me ligj** territorin në njësi të vetëqeverisjes lokale, duke marrë arasyshë **kritere të ndryshme**. Cilat janë ato kritere?

12.102. Vetëqeverisja lokale kufizon juridiksionin dhe kompetencën e organeve të pushtetit qendror në aspektin e **gjerësisë**, përkatësisht në bazë të punëve që kryen në mënyrë burimore, si dhe në aspektin e **thellësisë**, përmes kryerjes së punëve konkrete të komunitetit që drejtpërdrejt kanë të bëjnë me përditshmërinë e qytetarëve. Ilustroni këtë me shembuj konkret?

12.103. Përkufizimi i punëve mes pushteti qendror dhe vetëqeverisjes lokale mund të jetë i **përgjithshëm** dhe **konkret**. Diskutoni!

12.104. Bazuar në kriterin e pavarësisë së vetëqeverisjes lokale nga pushtetit qendror, dallohet **tri modele organizative**. Diskutoni!

12.105. Cila është marrëdhënia mes **shtetit bashkëkohor të mirëqenies** dhe **vetëqeverisjes lokale**?

12.106. Vetëqeverisjen lokale mund ta ndajmë në dy sisteme të mëdha: në **sistemin e njëllojtë** dhe në **sistemin me shumë lloje**. Diskutoni!

12.107. Sistemi vetëqeverisjes lokale mund të dallohet sipas numrit apo niveleve të pushtetit lokal. Diskutoni!

12.108. Nga cilat organe përbëhet organizimi i pushtetit në njësinë themelore të vetëqeverisjes lokale? Diskutoni secilin prej tyre!

12.109. Mund të dallohen **kompetencat burimore** dhe **kompetencat e bartura** të vetëqeverisjes lokale. Diskutoni!

12.110. Si financohet vetëqeverisja lokale?

12.111. Cilat janë **llojet e burimit të financimit të vetëqeverisjes lokale**?

12.112. Kontrolli e vetëqeverisjes lokale është **shprehje e marrëdhënies hierarkike** mes organeve të pushtetit në nivele të ndryshme. Çfarë është objekt i kontrollit dhe kush janë subjektet e tij?

12.113. Çka dallon **decentralizimi politik** prej **dekoncentrimit të pushtetit**?

12.114. Në mënyrë që pushteti qendror mos të abuzoj me pozitën hierarkie më të lartë në raport me vetëqeverisjen lokale, për këtë të fundit parashihet **e drejta e mbrojtjes**. Diskutoni!

12.115. Sipas **KVid**, vetëqeverisja lokale sanksionohet në tri nivele: komuna, rrethi (**srezi**) dhe regjioni (**oblast**). Ku ka qenë Kosova në këtë mes?

12.116. Sa i përket Kosovës së koh**ë**s së Jugosllavisë komuniste, n**ë lidhje me** vetëqeverisjen lokale, gjendja ka qenë më ndryshe se në krejt njësitë tjera të Jugosllavisë komuniste. Pse? Diskutoni!

12.117. Sipas nenit 116 të **Kushtetutës së RSFJ-së 1974**, **komuna** ishte një bashkësi themelore vetëqeverisëse dhe shoqërore-politike, njëjtë si në periudhën e mëhershme, e bazuar në pushtetin dhe vetëqeverisjen e klasës punëtore dhe të të gjithë të punësuarve. Si kanë qenë të përcaktuara të drejtat, detyrat si dhe organet e komunës në këtë kohë?

12.118. Cilat funksione ka realizuar komuna sipas **Kushtetutën e Kaçanikut** ?

12.119. Diskutoni, vetëqeverisja lokale në **Kosovë** në kohën e **UNMIK-**ut! Cilat akte kanë rregulluar atë dhe cila ka qenë përmbajtja e saj? Cilat kanë qenë organet e vetëqeverisjes lokale në këtë kohë?

12.120. Pas shpalljes së pavarësisë së vendit më 17 shkurt 2008, zhvillimi i qeverisjes lokale kishte kaluar në një faze tjetër juridike, për shkak të hyrjes në fuqi të KKos me 15 qershor 2008 dhe infrastrukturës se re ligjore. Që nga hyrja në fuqi e KKos, Kosova krijoi bazën kushtetuese dhe ligjore për vetëqeverisje lokale, ku njësia themelore, sikur edhe gjatë periudhës së administrimit ndërkombëtar nga UNMIK, mbeti komuna. Në përmbajtje, megjithatë, komuna e pavarësisë së Kosovës dhe ajo e kohë së UNMIK-ut kishin dallime substanciale. Pse?

12.121. Sipas modelit të decentralizimit që mishërohet në Aneksin III të **Planit Ahtisari**, modeli i decentralizimit ngërthen disa **karakteristike unike** që nuk gjenden askund në regjionin e Ballkanit. Cilat janë ato?

12.122. Në ndërkohë që dispozitat tjera të kapitullit të tretë të KKos, sanksionojnë në mënyrë universale tipin e demokracisë kushtetuese kosovare, **demokracinë konsiciacionale**, ku qeverisja lokale i shërben qëllimit të përgjithshëm të kushtetutëbërësit kosovar për përfaqësim të të gjitha komuniteteve në sistemin kushtetues nacional, neni 81 i **KKos** efektivisht paraqet një dispozitë kushtetuese që favorizon dhe mbron ekskluzivisht komunitetin serb të Kosovës. Çka do të thotë kjo? Cila është përmbajtja e këtij neni? Çka përcakton ky nen?

12.123. Për të qenë të sigurt në sigurimin dhe garantimin e këtyre të drejtave kushtetuese, kushtetutëbërësi kosovar ka vënë një **klauzolë shpëtimi** (“saving clause“) për komunitetin serb, që

gjenden në dispozitën e paragrafit të dytë të nenit 81 të KKos. Për çka bëhet fjalë këtu?

12.124. Cilat janë pasojat e implementimit të **Statutit të A/BKS** për rendin kushtetues të Kosovës?

12.125. Cilat janë burimet e së drejtës të qeverisjes lokale në **Kosovë**?

12.126. Me statutin e komunës rregullohen disa çështje të rendesishme. Cilat janë ato?

12.127. Cilat janë organet kryesore të komunës në **Kosovë**? Cilat janë kompetencat e tyre?

12.128. Cilat janë llojet e mbledhjeve të kuvendit komunal?

12.129. Në cilat raste mund të shpërndahet kuvendi komunal?

12.130. Kur përfundon mandati i kryetarit të komunës?

12.131. Cilat janë kompetencat e kryetarit të komunës?

12.132. Në Kosovë, **Ligji për vetëqeverisjen lokale** përcakton tri (3) kategori të kompetencave të cilat i ushtrojnë komunat kosovarë. Cilat janë ato?

12.133. Në **Republikën e Kosovës**, disa komuna, ku **komuniteti serb** është shumice, gëzojnë **kompetenca vetjake të zgjeruara** në fusha të caktuara. Ky përcaktim e ka burimin nga **Plani Ahtisari**, i cili në kuadër të procesit të decentralizimit i kishte të parapara këto kompetenca (Aneksi III, neni 4 i Planit Ahtisari). Në cilat fusha janë ato kompetenca?

12.134. **Ligjin për financat e pushtetit lokal** i ka përcaktuar burimet financiare komunale dhe llojet e tyre. Cilat janë ato?

12.135. Përveç ASK, në Kosovë pritet të formohet edhe **A/BKS**, bazuar në **MO**, përmes së cilës përligjësohen dhe fuqizohen të gjitha tratativat e Kosovës me të cilat është marrë përsipër detyrimi i vendit për themelim të kësaj strukture parashtetërore serbe. Pse kjo strukturë ka karakter të strukturës apo entitetit parashtetëror? Diskutoni gjerësisht duke analizuar dispozitat e akteve juridike që kanë çuar në ndërtimin e saj!

12.136. **Ligji për vetëqeverisjen lokale** ka përcaktuar mekanizmat e pjesëmarrjes se qytetareve në **demokracinë e drejtpërdrejtë**, në nivelin lokal. Cilat janë mekanizmat e pjesëmarrjes se qytetareve në demokracinë e drejtpërdrejtë në nivelin lokal ?

12.137. **Ligji për vetëqeverisje lokale** njeh edhe **referendumin**, si formë të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje. Për cilat çështje mbahet referendumi?

12.138. Ekzistojnë **dy lloje** të **shqyrtimit dhe mbikëqyrjes administrative** të komunave. Diskutoni!

12.139. Ligji për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës përcakton **dy lloje te shqyrtimit te ligjshmërisë**. Cilat janë ato? Diskutoni!

12.140. Cilat segmente të vetëqeverisjes lokale i mbron komuna përmes GJKRKS?

12.141. Një ndër palët e autorizuara në **GJKRKS**, për të mbrojtur të drejtat e komuniteteve në komunën përkatëse është edhe **zevëndëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete**. Diskutoni këtë kompetencë të GJKRKS në dritën e rastit KO 01/09 të **GJKRKS**!

12.142. Cilat janë kompetencat e komunës së **Prishtinës** në sferën e sigurisë publike dhe me çka rregullohen ato?

12.143. Shteti i pavarur shqiptar ka filluar jetën e tij, përmes ligjeve për organizimin e pushtetit vendor, gjë që dëshmon konceptet e drejta të klasës politike të kohës, për rëndësinë e organizimit të qeverisjes vendore në shtet. Cili ka qenë akti i parë juridik në këtë drejtim?

12.144. Sikundër dihet, një prej parimeve më moderne të qeverisjes vendore, ai i decentralizimit, ishte afirmuar nga rilindasi ynë kombëtar **Sami Frashëri**. Diskutoni?

12.145. Shteti shqiptar është krijuar si **shtet unitar** dhe ka mbetur historikisht i tillë. Cili ka qenë mendimi i **Ismail Qemalit** lidhur me formën e shtetit shqiptar?

12.146. Cili ka qenë ndikimi i standardeve ndërkombëtare në sistemin e qeverisjes lokale në Shqipëri? Diskutoni!

12.147. Cilat janë njësitë e vetëqeverisjes vendore në Shqipëri?

12.148. Në KShq, mëvetësia kushtetuese e njësive të qeverisjes vendore nuk është vetëm një mëvetësi administrative. Ajo paraqitet si një **autonomi politike**, **normative** dhe **financiare**. Diskutoni këtë duke krahasuar me rastin e Kosovës!

12.149. Në KShq parimi i vetëqeverisjes vendore, i proklamuar në nenin 108 të **KShq**, ushtrohet nëpërmjet **organeve përfaqësuese vendore** dhe **referendumeve vendore.** Diskutoni këtë

duke krahasuar me rastin e Kosovës!

12.150. Çfarë tregojnë vendimet e GJKShq lidhur me vetëqeverisjen vendore?

12.151. Në Maqedoninë e Veriut, vetëqeverisja lokale merr kthesë pozitive me amendamentet e vitit 2001. Diskutoni!

12.152. Cilat janë karakteristikat e përbashkëta të vetëqeverisjes lokale në Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi dhe Serbi?

12.153. Cilat janë dallime mes vetëqeverisjes lokale në Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi dhe Serbi?

12.154. Diskutoni të përbashkëtat dhe dallimet mes vetëqeverisjes lokale në Kosovë dhe vendet tjera përreth, përveç Shqipërisë?

13. Lexim shtesë

- Aleks Luarasi, *Aktet juridike për historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri* (OMBRA GVG: Tiranë, 2014)
- Anders Lidstrom, "The Comparative Study of Local Government Systems - A Research Agenda" *Journal of Comparative Policy Analysis: Research and Practice* Vol. Issue 1 (1998)
- Carl T. Dahlman, "Faire frontière dans la paix: le Kosovo et la décentralisation de la çoncurrence ethno-politique" *L'Espace Politique* Vol. 33 No. 3 (2017)
- Carlo Salone, "Questioning new regionalism from an Italian perspective, or the resistible rise of Italian regions" *Pôle Sud* Vol. 46 No. 1 (2017)
- Elliot Bulmer, *Federalism* (IDEA: Stockholm, 2017)
- Fehmi Agani, *Studime sociologjike dhe politologjike* (ASHAK: Prishtinë, 2008)
- Laurent DEPUSSAY, "L'unite etatiques au moyen des asymmetries institutionnelles" *Revue française d'administration publique* Vol. 1 No. 121-122 (2007)
- Lef Nosi, *Dokumente historike: 1912-1918* (Tiranë, 2007)
- Luciano Vandelli, "Du regionalism au federalism?" *Pouvoirs* Vol. 4 No. 103 (2002)
- Luciano Vandelli, "Formes et tendances des rapports emntre etats et collectives territoriales". *Revue française d'administration publique* Vol. 1 No. 121-122 (2007)
- Luke Philip Plotica, "Federalism, Devolution, and Liberty" *American Political Thought* Vol. 6 No. 1 (Winter 2017)
- Magali Gravier, "Empire vs federation: which path for Europe?" *Journal of Political Power* Vol. 4 Issue 3 (2011)
- María José Hierro, "Regional and National Identities in Spain" **Në** Diego Muro and Ignacio Lago (eds.), *The Oxford Handbook of Spanish Politics* (Oxford University Press: Oxford, 2020)
- Michael Burgess, "Small Worlds: The Character, Role and Significance of Çonstituent Units in Federations and Federal Political Systems" *L'Europe en Formation* Vol. 13 No. 369 (2013)
- Michael Burgess, *Comparative Federalism Theory and Practice* (Routledge: London and New York, 2006)
- Philipp Dann, Michael Reigner, and Maxim Bonnemann (eds.), *The Global South and Comparative Çonstitutional Law* (Oxford University Press: Oxford, 2020)
- Tom Ginsburg and Eric Posner, "Subconstitutionalism" *Stanford Law Review* Vol. 62 Issue 6 (June 2010)

LITERATURA

A. Libra:

- Aidan Hehir (ed.), Kosovo, Intervention and Statebuilding: The International Community and the Transition to Independence (Routledge: London and New York, 2010)
- Afrim Krasniqi, Sistemet politike në Shqipëri. Botimi dytë (UFO Press: Tiranë, 2009)
- Aisling Lyon, Aisling, Decentralisation and the Management of Ethnic Conflict: Lessons from the Republic of Macedonia (Routledge: London and New York, 2015)
- Alan Norton, International Handbook of Local and Regional Government. A Comparative Analysis of Advanced Democracies. (Edward Elgar: Aldershot, 1994)
- Albert V. Dicey, Introduction to the Study of the Law of the Constitution (8 ed.) (Macmillan: London, 2015)
- Albert Venn Dicey, Introduction to the Law of the Constitution (Liberty Classics: Indianapolis, 1982)
- Aleks Luarasi, Akte Juridike për Historinë e Shtetit dhe të Drejtës në Shqipëri. Botim i Dytë (OMBRA GVG: Tiranë, 2014)
- Aleks Luarasi, Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri (MALUKA: Tiranë, 2018)
- Aleksandar Molnar, Rasprava o demokratskoj ustavnoj državi. 2. Klasične revolucije: Nizozemska, Engleska, SAD (Samizdat B92: Beograd, 2001)
- Aleksandar Molnar, *Rasprava o* demokratskoj i ustavnoj drzavi: 1. Pravo na otpor tiraniji (Samizdat B92: Beograd, 2001)
- Aleksandar Ranković*, Dnevničke zabeleške* (Jugoslovenska knjiga: Beograd, 2001)
- Ana S. Trbovich, A Legal Geography of Yugoslavia's Disintegration (Oxford University Press: Oxford, 2008)
- András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), Comparative Constitutional Reasoning (Cambridge University Press: Cambridge, 2017)
- Andras Sajo, Limiting the Government. An Introducion to Constitutionalism. (CEU Press: Budapest, 1999)
- Andrew Coulson (ed.), Local Government in Eastern Europe. Establishing Democracy at the Grassroots (Edward Elgar: Aldershot, 1995)
- Annie K. Smart, Citoyennes: Women and the Ideal of Citizenship in Eighteenth-Century France (University of Delaware Press: Newark, 2011)
- Arben Puto, Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926 (Botimet DUDAJL 2010)
- Arista Maria Cirtautas, France. Në Jeffrey Kopstein, Mark Lichbach (eds.), Comparative Politics Interests, Identities, and Institutions in a Changing Global Order (Cambridge University Press: Cambridge, 2000)
- Arjan H. Schakel (ed.), Regional and national elections in Eastern Europe: territoriality of the vote in ten countries (Palgrave Macmillan: London, 2017)
- Aroline Warman (ed.). Tolerance: The Beacon of the Enlightenment (1st ed., Vol. 3). Open Book Publishers (2016)
- Arsen Bačić, *Komentar Ustava Republike Hrvatske* (Pravni fakultet u Splitu: Split, 2002)
- Aurela Anastasi, Historia e të Drejtës Kushtetuese në Shqipëri (1912-1939) ("Dajti 2000": Tiranë 2018)
- Aurelian Craiutu., Liberalism under Siege: The Political Thought of the French Doctrinaires (Lexington Books: USA, 2003)
- Avi Lifschitz (ed), Engaging with Rousseau: Reception and Interpretation from the Eighteenth Century to the Present (Cambridge University Press: Cambridge, 2016)
- Barbara Jelavich, History of the Balkans. Twentieth Century. Volume 2 (Cambridge University Press: Cambridge, 1983)
- Baron de Montesquieue, *The Spirit of the Laws,* trans. Anne M. Cohler, Basia Carolyn Miller,

and Harold Samuel Stone. Cambridge Texts in the History of Political Thought (Cambridge University Press: Cambridge, 1989)
- Besnik Tahiri, Politika e Decentralizimit në Kosovë-Ndikimi në reformën e vetëqeverisjes Lokale (Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale: Prishtinë, qershor 2008)
- Blake Emerson, The Public's Law: Origins and Architecture of Progressive Democracy (Oxford University Press: Oxford, 2019)
- Bojan Dimitrijević, *Ranković – drugi* čovek (Vukotic media: Beograd, 2019)
- Boris Mirkine-Guetzévitch et Université de Paris - Institut de droit comparé, La pensée politique et constitutionnelle de Montesquieu: Bicentenaire de l'Esprit des lois 1748-1948. Publié avec le concours du Centre national dé la recherche scientifique (Recueil Siroy: Paris, 1952)
- Branimir M Janković, The Balkans in International Relations (Mcmillan Press: London, 1988)
- Branko Smerdel, O USTAVIMA I LJUDIMA. Uvod u ustavnopravnu kazuistiku (Novi Informator: Zagreb: 2012)
- Brano Smerdel & Smiljko Sokol, Ustavno pravo. Četvrto neizmenjeno izdanje (Narodne Novine: Zagreb, 2009)
- Brewer-Carias, R., Allan (2011) Constitutional Courts as Positive Legislators. A Comparative Law Study. (Cambridge University Press: Cambridge, 2010)
- Brian C. H. Fong and Atsuko Ichijo, The Routledge Handbook of Comprative Territorial Autonomies (Routledge: London and New York, 2022)
- Brij Kishore Sharma, Introduction to the Constitution of India (Prentice – Hall of India: New Delhi, 2007)
- Carl J. Friedrich, Constitutional Government and Democracy: Theory and Practice in Europe and America (Ginn and Company: Boston, 1950)
- Carl Schmitt, Constitutional Theory, Trans and ed. by Jeffrey Seitzer (Duke University Press: Durham and London, 2008)
- Carlo Lavagna, Istituzioni di diritto publico. Volume primo (Unione Tipografico – Editrice Torinese: Torino, 1970)
- Cass R. Sunsstein, Designing Democracy: What Constitutions Do (Oxford University Press: Oxford, 2001)
- Catherine Ashton, And Then What?: Inside Stories of 21st-Century Diplomacy (Elliott & Thompson: London, 2023)
- Cesare P.R. Romano, André Nollkaemper and Jann K. Kleffner (eds.), Internationalized Criminal Courts: Sierra Leone, East Timor, Kosovo, and Cambodia (Oxford University Press: Oxford 2004)
- Chilton Williamson, American Suffrage: From Property to Democracy, 1760-1860 (Princeton University Press: Princeton, 1960)
- Christina Bell, Capitualtions. Max Planck Encyclopedia of Public International Law (July 2009)
- Christopher B. Gray, The Methodology of Maurice Hauriou: Legal, Sociological, Philosophical (Rodopi: Amsterdam, New York, NY: 2010)
- Clifton E. Olmstead, History of Religion in the United States (Prentice-Hall, Inc.: Englewood Cliffs, N. J., 1960)
- Costantino Mortati, La Costitutzione in senso materiale (Giuffrè Editore: Milano, 1940)
- Daniel Bethlehem, The"Yugoslav" crisis in international Law: General issues (Cambridge University Press: Cambridge, 1997)
- Danny Evans, Revolution and the State: Anarchism in the Spanish Civil war, 1936–1939 (Routledge: London and New York, 2018)
- Dejan Jović, Yugoslavia: A State that Withered Away (Purdue University Press: West Lafayette, Indiana, 2009)

- Denisa Kostovicova, Kosovo: The politics of identity and space (Routledge: London, 2005)
- Dennis F. Thompson, John Stuart Mill and Representative Government (Princeton Legacy Library: Princeton, 1976)
- Dick Leurdijk and Dick Zandee, Kosovo: From crisis to crisis (Routledge: London and New York, 2001)
- Dimitar Bechev, Rival Power. Russia's Influence in South East Europe (Yale University Press: Yale, 2017)
- Dimitrije Kulic, Ustavno sudstvo u svetu. Drugo Izdanje (Leskovac, 1972)
- Diogo Pires Aurélio and Andre Santos Campo (eds.), Machiavelli's Discourses on Livy: New Readings (Brill: Leiden, 2021)
- Dominique Chagnollaud, Michel Troper, Traité international de droit constitutionnel. Distribution des pouvoirs. Tome 2 (Traités Dalloz: Paris, 2012)
- Donald P. Kommers".The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany. Second Edition' (Durham and London: Duke University Press: Durham and London, 1997)
- Donald Quataret, The Ottoman Empire 1700-1922 (Cambridge University Press: Cambridge, 2005)
- Donato Giannotti, Republica Fiorentina (Droz: Genève, 1990, Florence: 1990)
- Đorđije Blažić, Zarobljeni izborni sistem (FDES: Podgorica, 2021)
- Đorđije Blažić, Sistem lokalne samouprave (Teorijsko, međunarodno-pravno, komparativno i pozitivno-pravno) (Fakultet za državne i evropske studije – Podgorica, 2011)
- Dr. Skender Skenderi, Si veproi Kuvendi i Republikës së Kosovës. Vëllimi II-të (20.07.1990-1996) (Printing Press: Prishtinë, 2016)
- Dusan Papadopolos, AVNOJ i narodno oslobodilačka borba u Bosni i Hercegovini: 1942-1943: materijali sa naučnog skupa održanog u Sarajevu 22. i 23. novembra 1973. godine (Rad: Beograd, 1974)
- Dhimo M. Dhima, E DREJTA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË (Fakulteti Juridik i Universitetit Shtetëror të Tiranës: Tiranë, 1963)
- E. S. Staveley, Greek and Roman voting and elections (Cornell University Press: Ithaca, N.Y., 1972)
- Edgar O' Balance, The Greek Civil War, 1944–1949 (Faber & Faber: London, 1966)
- Edina Bećirević, Edina (2014). Genocide on the Drina River (Yale University Press: Yale, 2014)
- Edward Harris and Lene Rubinstein (eds), The Law and Courts in Ancient Greece (Duckworth: London, 2004)
- Edward L Rubin, Beyond Camelot: Rethinking Politics and Law for the Modern State (Princeton University Press: Princeton, NJ, 2005)
- Elena Kocaqi, Si e krijoi Austro-Hungaria Shtetin shqiptar (EMAL: Tiranë, 2019)
- Emmerich de Vattel, The Law of Nations (1758)
- Enver Hasani & Muhamet Brahimi, Gjyqësia kushtetuese (Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina": Prishtinë, 2021)
- Enver Hasani dhe Ivan Cukalovic, Komentar. Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Botimi parë (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH: Prishtinë, 2013)
- Enver Hasani, "E drejta kushtetuese dhe të drejtat e njeriut – Parimet dhe institucionet". Në Grup autorësh (eds.), Hyrje në sistemin ligjor në Kosovë (Akademia e Drejtësisë: Prishtinë, 2019)
- Enver Hasani, E DREJTA KUSHTETUESE Studim kritik mbi librin "E drejta kushtetuese" të autorëve A. Bajrami e F. Muçaj, (Jalifat Publishing: Hjuston, Teksas, SHBA, 2018)
- Enver Hasani, Tema të zgjedhura nga e drejta dhe marrëdhëniet ndërkombëtare (Universiteti i Prishtinës"Hasan Prishtina, Prishtinë, dhe JALIFAT Publishing, Huston, Teksas, SHBA, 2016)

- Esat Stavileci, Odgovornost u samoupravnom društvu (Pokrajinski centar za marksističko obrazovanje: Priština, 1977)
- Esat Stavileci, Shteti, vetqeverisja dhe sistemi i delegimit: përvoja dhe praktika (Flaka e vëllazërimit: Shkup, 1978)
- Fatmira Musaj, Republika Shqiptare: 1925-1928 (Instituti i Historisë: Tiranë, 2018)
- Florian Bieber, Židas Daskalovski (eds.), Understanding the war in Kosovo (Psychology Press: London, 2003)
- Francis Hamon dhe Michel Trope, Droit constitutionnel. 37e edition (Paris: L. G.D.J., 2016)
- Frank Vibert, The Rise of the Unelected: Democracy and the New Separation of Powers (Cambridge University Press: Cambridge, 2007)
- Geoffrey Hindley, A Brief History of the Anglo-Saxons (Robinson: London, 2006)
- Georg Jellinek, The Declaration of the Rights of Men and Citizens (Henry Holt and Company: New York, 1901)
- Giovanni Sartori, The Theory of Democracy Revisted. Part One (Chatham House Publishers, Inc.: New Jersey, 1987)
- Gordana Siljanovska – Davkova, Vladimir Mitkov, Tanja Karakamisheva – Jovanovska, Aleksandar Spasenovski, Marko Krtopica, Lokalna samouprava (Konrad Adenauer Shtiftung: Skopje 2020)
- Gordon Wood, The Creation of the American Republic 1776–1787 (University of North Carolina Press: Chapel Hill, 1969)
- Guy Goodwin-Gill and Stefan Talmon (eds.), The Reality of International Law. Essays in Honour of Ian Brownlie (Oxford University Press: Oxford, 1999)
- Hans Kelsen, Pure Theory of Law (The Lawbook Exchange, Ltd.: Clark, New Jersey, 2002, 2009)
- Hans Kelsen, The Pure Theory of Law (California University Press: Berkeley and Los Angeles, 1967)
- Hélène Simonian-Gineste, Droit constitutionnel en schémas. 8e édition (Ellipses: Paris, 2021)
- Henry Roussillon, Xavier Bioy et Stephane Mouton (eds.), Le nouveaux objets du droit constitutionnel Presses de l'Universite des sciences sociales de Toulouse: Toulouse, 2006)
- Herman Schwartz, The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe (The University of Chicago Press: Chicago, 2000)
- Independent International Commission on Kosovo (2000). The Kosovo report: conflict, international response, lessons learned (Oxford University Press: New York, New York, 2000)
- J. G. Fichte, Foundations of Natural Rights According to the Principles of the Wissenschaftslehre [1796] Michael Baur (trans) Frederick Neuhouser (ed) (Cambridge University Press: Cambridge, 2000)
- Jacques-Vincent Delacroix, Constitutions des principaux états de l'Europe et des États-Unis de l'Amérique (Buisson: Paris, 1791 à 1801)
- James Bryce, Constitutions (Oxford University Press, American Branch: New York, 1905)
- James Horncastle, The Macedonian Slavs in the Greek Civil War, 1944-1949 (Lexington Books: London and New York, 2019)
- James Ker-Lindsay, Kosovo: The Path to Contested Statehood in the Balkans (I.B.Tauris & Co. Ltd.: London, 2009)
- James L. Hyland. Democratic theory: the philosophical foundations. (Manchester University Press: Manchester, 1995)
- James M. Blythe, Ideal Government and the Mixed Constitution in the Middle Ages (Princeton University Press: Princeton, 2014)
- James Madison, Alexander James and John Jay, The Federalist Papers (Penguin: Harmondsworth, 1987)
- Jane Stromseth, David Wippman, Rosa Brooks, Can Might Make Rights?: Building the Rule

of Law after Military Interventions. First Edition (Cambridge University Press: Cambridge, 2006)
- Janusz Bugajski, Janusz (2016). Ethnic Politics in Eastern Europe: A Guide to Nationality Policies, Organizations and Parties (Routledge: London and New York, 2016)
- Jasna Dragović-Soso, "Saviours of the Nation": Serbia's Intellectual Opposition and the Revival of Nationalism (C. Hurst & Co. Ltd.: London, 2002)
- Jean Bodin, The Six Bookes of a Commonweale. Richard Knolles (trans) [1606] Kenneth Douglas McRae (ed) (Cambridge, MA: Harvard University Press, 1962)
- Jean Jacques Rousseau, Emile or On Education (Basic Books: USA, 1979)
- Jean Jacques Rousseau, The Social Contract Or Principles of Political Right. Translated by G. D. H. Cole. (Constitution Society) (Original: 1762)
- Jean Salem, Vincent Denis and Pierre-Yves Quiviger (eds.) FIGURES DE SIEYÈS. PHILOSOPHIE (Éditions de la Sorbonne: Paris, 2008)
- Jean-Louis de Lolme, David Lieberman (ed.), The Constitution of England (Liberty Fund: Indianapolis, Ind., 2007)
- Jerzy Makarczyk (ed.), Theory of International Law at the Threshold of the 21st Century: Essays in Honour of Krzysztof Skubiszeëski (Kluwer Law International: The Hague, 1996)
- Joel Colón- Ríos, Constituent Power and the Law (Oxford University Press: Oxford, 2020)
- John C. Hall, Rousseau: Totalitarian or Liberal? (Columbia University Press: New York, 1956)
- John Locke, Second Treatise of Government and A Letter Concerning Toleration (B. Blackwell: Oxford, 1948)
- John McCormick, Understanding the European Union: a Concise Introduction (Palgrave: Basingstoke, 2002)
- John Morris Roberts, A General History of Europe: 1880-1945. Sixth impression (Longman Group Ltd.: London and New York, 1976)
- John Stuart Mill*, Consideratiuon on Representative Government (Cambridge University Press: Cambridge, 2011)*
- Jonathan Doucette. The Roots of Urban Self-Government (PhD Dissertation). Submitted August 31, 2020. The public defense takes place November 6, 2020. Published November 2020. Department of Political Science. Aarhus BSS, Aarhus University
- Joost Augusteijn, Eric Storm (eds), Region and State in Nineteenth-Century Europe (Palgrave Macmillan, London, 2012)
- Jorri C. Duursma, Jorri Carolina Duursma, Fragmentation and the International Relations of Micro-states: Self-determination and Statehood (Cambridge University Press: Cambridge, 1996)
- Jovan Gjorgjeviq, E DREJTA KUSHTETUESE (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i KSAK: Prishtinë, 1972)
- Juan J. Linz and Arturo Valenzuela (eds.), The Failure of Presidential Democracy, Vol. 1 (The Johns Hopkins Univesity Press: Baltimore Maryland and London, 1994)
- Julie Mertus, Kosovo: How myths and truths started a war (University of California Press: Berkeley, 1999)
- Justin O. Frosini, Constitutional Preambles: At a Crossroads between Politics and Law (Maggioli: Santarcangelo di Romagna, Italia, 2012)
- Karel Vasak, "A 30 Year Struggle". UNESCO Courier (November 1977)
- Karel Wellens, ed., International Law: Theory and Practice Essays in Honour of Eric Suy. (The Hague: Martinus Nijhoff, 1998)
- Karl J. Fridrih, Kosntitucionalna Demokratija (CID: Podgorica, 2009)
- Karl Loewenstein, Political Power and the Governmental Process (University of Chicago Press: Chicago, 1957)
- Karl Loewenstein, Political Reconstruction (Macmillan Co.: New York, 1948)

- Kate Transchel, The Breakup of Yugoslavia: Conflict in the Balkans (Chelsea House: New York, 2007)
- Katharine G. Young Constituting Economic and Social Rights (Oxford University Press: Oxford, 2012)
- Ker-Lindsay, Kosovo: The Path to Contested Statehood in the Balkans (I.B.Tauris & Co. Ltd.: London, 2009)
- Klejda Mulaj, Politics of ethnic cleansing: nation-state building and provision of in/security in twentieth-century Balkans (Lexington Books: New York etc., 2008)
- Kristo Floqi, E DREJTA THEMELORE OSE KONSTITUCJONARE (HUKUKI- ESASIJE) (Shtypshkronja Franciskane: Shkodër, 1920)
- Ksenofon Kristafi, Organizimi politik në Shqipëri (UET Press: Tiranë, 2014)
- Kurtesh Salihu, *E drejta kushtetuese*. Botimi i katërt (Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës: Prishtinë, 2004)
- Kurtesh Salihu, Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e autonomitetit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në Jugosllavinë Socialiste (Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës: Prishtinë, 1984)
- Kyriaki Topidi & Lauren Fielder (eds.), Transnational Legal Processes (Routledge: London and New York, 2013)
- Laurence Morel and Matt Qvortrup (eds.), The Routledge Handbook to Referendums and Direct Democracy (Routledge: New York, 2018)
- Lee Ward, Modern Democracy and the Theological-Political Problem in Spinoza, Rousseau, and Jefferson (Palgrave Macmillan: New York, 2014)
- Lef Nosi, Dokumente Historike (1912-1918) (Instituti i Historisë: Tiranë 2007)
- Liljana Slavnić, Ustavno pravo (Privredna Akademija: Novi Sad, 2007)
- Loring Danforth, The Macedonian Conflict: Ethnic Nationalism in a Transnational World (Princeton University Press: Princeton, 1997)
- Louis Favoreu & Wanda Mastor, Les cours constitutionnelles (DALLOZ: Paris, 2016)
- Louis Favoreu et. al, Droit constitutionnel (Dalloz: Paris, 2017)
- Louis Favoreu, Patrick Gaïa, Richard Ghevontian, Jean-Louis Mestre, Otto Pfersmann, André Roux, Guy Scoffoni, Droit constitutionnel. 21e edition (DALLOZ: Paris, 2019)
- Louis Favoreu, Patrick Gaïa, Richard Ghevontian... [et al.], Droit constitutionnel 19e édition (Dalloz: Paris, 2017)
- Luan Omari, Aurela Anastasi, E drejta kushtetuese ("Dajti 2000": Tiranë, 2010)
- Luan Omari, Aurela Anastasi, E drejta kushtetuese ("Dajti 2000": Tiranë, 2017)
- Lucas Prakke and Constantijin Kortmann (eds.), Constitutional Law of 15 EU Member States (Kluwer Legal Publishers: Deventer, The Netherlands, 2004)
- M. J. C. Vile, Constitutionalism and the Separation of Powers. 2nd Edition (Liberty Fund, Inc.: USA, 1998)
- Maartje de Visser, Constitutional Review in Europe. A Comparative Analysis (Hart Publishing: Oxford, 2013)
- Mal Berisha, HERMAN BERNSTEIN. Ambasador i SHBA-ve në Mbretërinë Shqiptare (EduAlba: Tiranë, 2017)
- Malgosia Fitzmaurice, "Badinter Commission (for the Former Yugoslavia)" Max Planck Encyclopedia of Public International Law [MPEPIL] (June 2019) (Oxford University Press: Oxford, 2023)
- Marc Uyttendaele, Trente leçons de droit constitutionnel, (Bruxelles: Brylant, 2014)
- Marc Weller, Shtetësia e kontestuar. Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi (KOHA: Prishtinë, 2009)
- Marcel Prélot & Jean Boulouis, Institutions politiques et droit constitutionnel. Onzième édition (Précis Dalloz: Paris, 1990)
- Marco Barducci, Hugo Grotius and the Century of Revolution, 1613-1718: Transnational

Reception in English Political Thought (Oxford University Press: Oxford, 2017)
- Mari-Žanin Čalić, Istorija Jugoslavije U Xx Veku, (CLIO: Beograd, 2013)
- Mari-Žanin Čalić, Istorija Jugoslavije u XX veku, (CLIO: Beograd, 2004)
- Mark A. Petersen, Legislating Together: The White House and Capitol Hill from Eisenhower to Reagan (Harvard University Press: Cambridge MA, 1993)
- Mark Silverstein, Judicious Choices: The New Politics of Supreme Court Confirmations (W.W. Norton and Company: New York, 1994)
- Mark Tushnet, Thomas Fleiner and Cheryl Saunders (eds.), Rutledge Handbook of Constitutional Law (Routledge: Abongdon, 2012)
- Marsilius of Padua, Defensor Pacis. Translated by Alan Geëirth (Harper & Row: New York, 1967)
- Martin Loughlin, Foundations of Public Law (Oxford University Press: Oxford, 2010)
- Martin Scheinin (ed.), Welfare State and Constitutionalism - Nordic Perspectives (Nordic Council of Ministers: Copenhagen, 2001)
- Martin Vöhler, Stella Alekou and Miltos Pechlivanos (eds.), Concepts and Functions of Philhellenism. Aspects of a Transcultural Movement (DE GRUYTER: Berlin/Boston, 2021)
- Matthew Soberg Shugart and John M. Carey, Presidents and Assemblies. Constitutional Design and Electoral Dynamics (Cambridge University Press: Cambridge, 1992)
- MAURICE HAURIOU, PRÉCIS DE DROIT ADMINISTRATIF CONTENANT LE DROIT PUBLIC ET LE DROIT ADMINISTRATIF (LIBRAIRIE DU RECUEIL GÉNÉRAL DES LOIS ET ARRÊTS: Paris, 1893)
- MAURICE HAURIOU, PRÉCIS ÉLÉMENTAIRE DE DROIT CONSTITUTIONNEL. DEUXIEME ÉDITION (LIBRAIRIE DU RECUEIL SIREY: Paris, 1930)
- Mauro Volpi, Libertà e autorità. La classificazione delle forme di Stato e delle forme di governo. Settima edizione (G. Giappichelli Editore: Torino, 2018)
- Melihate Termkolli, Marsi i Acartë (Kolegji AAB: Prishtinë, 2022)
- Melissa Katherine Bokovoy, Jill A Irvine, Carol S. Lilly, (1997). State-society relations in Yugoslavia, 1945-1992 (Palgrave Macmillan: Scranton, Pennsylvania, USA, 1997)
- Michel Rosenfeld and Andras Sajo (eds.), The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law (Oxford University Press: Oxford, 2012)
- Michel Troper et Dominique Chagnollaud (eds.), Traite international de droit constitutionnel. Tome 1: Theorie de la Constitution (Dalloz: Paris, 2012)
- Michel Troper et Dominiques et Chagnollaud (eds.), Traité international de droit constitutionnel. Tome 2: Distribution des pouvoirs (Dalloz: Paris, 2012)
- Michel Troper et Dominiques et Chagnollaud (eds.), Traité international de droit constitutionnel. Tome 3: Suprématie de la Constitution (Dalloz: Paris, 2012)
- Mijat Šuković, Ustavno pravo (CID: Podgrica, 2009)
- Mijat Šuković, Ustavno pravo Vladimir Goati, Srđan Darmanović (eds.), IZBORNI I PARTIJSKI SISTEM U CRNOJ GORI. PERSPEKTIVA RAZVOJA UNUTARPARTIJSKE DEMOKRATIJE (CEMI, Podgorica, 2014)
- Milivoje Kovacevic, Komunalni sistem i komunalna politika (Zavod za idavanja udjbeniak SR Srbije: Beograd, 1968)
- Milovan Buzadzić, Secesija bivsih jugoslovenskih republika u svetlosti odluka Ustavnog dusa Jugoslavije (NIU, Službeni list SRJ: Beograd, 1994)
- Milovan Djilas, Tito: The Story from Inside (Harcourt Brace Jovanovich: New York, 1980)
- Miller, Fred D, *Nature, Justice, and Rights in Aristotle's Politics* (Oxford University Press: Oxford, 1997)
- Minton F. Goldman, Minton F (1997). Revolution and Change in Central and Eastern Europe: Political, Economic, and Social Challenges (M.E. Sharpe: New York, 1997)
- Miranda Vickers, Between Serb and Albanian: A History of Kosovo (Columbia University Press: New York, 1998)

- Mladen Vukčević, Komentar Ustava Crne Gore (Univerzitet MEDITERAN: Podgorica, 2015)
- Molnar, RASPRAVA O DEMOKRATSKOJ USTAVNOJ DRŽAVI. 1. Pravo na otpor tiraniji (Samizdat B92: Beograd, 2001)
- mr Zlatko Vujović, mr Nikoleta Tomović, Održivi institucionalni mehanizmi za poboljšanje predstavljenosti manjina u crnogorskom Parlamentu (European Fund for the Balkans: Podgorica, 2020)
- Muaz Agushi, "Historiku i zgjedhjeve parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut (1990-2020)". Institute for Security Studies and Development. North Macedonia. 6, 10 dhe 13 korrik 2020
- Muin Çami, Shqipëria në marrëdhëniet ndërkombëtare (1914-1918) (Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë-Instituti i Historisë: Tiranë, 1987)
- Natalija Nikolovska & Gordana Siljanovska-Davkova, Tranzition in Deficiency- from Unitary toward Bi-national State (Skopje: Magor: Skopje, 2001)
- Nebojša Popov (ed.), The Road to War. Trauma and Catharsis (CEU Press: Budapest, 2000)
- Nicolas Richer, *Les éphores: études sur l'histoire et sur l'image de Sparte (VIIIe-IIIe siècle avant Jésus-Christ)*. *Histoire ancienne et médiévale / Université de Paris I, 50* (Publications de la Sorbonne: Paris, 1998)
- Noel Malcolm, Kosovo. A Short History (New York University Press: New York, 1998)
- Norman Schofield and Itai Sened, Multiparty Democracy. Elections and Legislative Politics (Cambridge University Press: Cambridge, 2006)
- Oliver Descamps & Rafael Domingo (eds.), Great Christian Jurists in French History (Cambrdge University Press: Cambridge: 2019)
- Oliver Gohin, Droit constituionnel (LexisNexis: Paris, 2013)
- Olivera Vucic, Austrijsko ustavno sudstvo – čuvar federacije i ustava (mbrojtur më 1995 në Fakultetin Juridik në Universitetin e Beogradit)
- Olivier Corten, Pierre Klein, Anne Lagerwall, et al., Droit du pouvoir, pouvoir du droit: Mélanges offerts à Jean Salmon (Bruylant: Brussels, 2007)
- Pablo Ruiz-Tagle, Five Republics and One Tradition: A History of Constitutionalism in Chile 1810-2020 (Cambridge University Press: Cambridge, 2021)
- Paolo Carrozza - Alfonso Di Giovine - Giuseppe F. Ferrari (eds.), Diritto costituzionale comparato (GLF Editori Laterza: Roma-Bari, 2009)
- Patrick Weiler, First Among Equals: Prime Ministers in Westminster Systems (George Allen & Unwin: Sydney, 1985)
- Paul G. Lewis, Political Parties in Post-Communist Eastern Europe (Routledge: London and New York, 2000)
- Peter Langford, Ian Bryan, John McGarry (eds.), Kelsenian Legal Science and the Nature of Law (Springer: Cham, 2017)
- Peter Mandler, Aristocratic Government in the Age of Reform Whigs and Liberals 1830-1852 (Clarendon Press: Oxford, 1990)
- Peter Radan, The Break-up of Yugoslavia and International Law (Routledge: London and New York, 2002)
- Philippe Ardant & Bertrand Mathieu, Droit constitutionnel et institutions politiques (LGDJ: Paris, 2016)
- Pier Vincenzo Uleri & Michael Gallagher (eds.), The Referendum Experience in Europe. 6th Edition (Palgrave Macmillan Basingstoke, 1996)
- Plato, Republic. Translated by C. D. C. Reeve (Hackett Publishing Company: Indianapolis and Cambridge, 2005)
- Polybius, The Complete Histories of Polybius Paperback (Digireads.com: January 1, 2009)
- R. A. W. Rhodes and Patrick Dunleavy, Prime Minister, Cabinet and Core Executive (Macimallan: Basingstoke, Hants. 1995)

- Rainer Arnold, Jose Ignacio Martinez-Estay (eds.), Rule of Law, Human Rights and Judicial Control of Power. Some Reflections from National and International Law (SPRINGER International Publishing AG: Switzerland, 2017)
- Randall Peerenboom *(ed*.), Asian Discourses of Rule of Law, Theories and Implementation of Rule of Law in Twelve Asian Countries, France and the US (Routledge Curzon: London, New York, 2004)
- Raphael Lemkin, Axixs Rule in Occupied Europe. Laws of Occupation, Analysis of Government Proposals for Redress (The Lawbook Exchange Ltd.: Clark, New Jersey, 2005)
- Ratko Marković, Ustavno pravo (Pravni fakultet Univerziteta u Beogradu: Beograd, 2016)
- Ratko Marković, Ustavno pravo i političke institucije (Glasnik: Beograd, 2008)
- Richard Albert and Joel Colón-Ríos (eds.), Quasi-Constitutionality and Constitutional Statutes. Forms, Functions, Applications (Routledge: United Kingdom, 2020)
- Richard Batley and Gerry Stoker (eds.), Local Government in Europe. Trends and Developments (Macmillan: Houndsmills, 1991)
- Robert Alexy, A Theory of Constitutional Rights (Oxford University Press: Oxford, 2010)
- Roger Brock and Stephen Hodkinson (eds.), Alternatives to Athens: Varieties of Political Organization and Community in Ancient Greece (Oxford, 2002)
- Roger D. Petersen, Western Intervention in the Balkans: The Strategic Use of Emotion in Conflict. (Cambridge University Press: Cambridge: 2011)
- Romeo Gurakuqi, Shqipëria dhe ”Tokat e Lirueme”: 1939-1946 (Botimet Josef: Tiranë, 2018)
- Rosa Mule, Political Parties, Games and Redistribution (Cambridge University Press: Cambridge, 2004)
- Sami Frashëri, Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet (Rilindja: Prishtinë, 1978)
- Silvia Suetu, Eternity Clauses in Democratic Constitutionalism (Oxford University Press: Oxford, 2021)
- Simone Pajno, “Regionalism in the Italian Constitutional System” Diritto et Questioni Pubbliche No. 9 (2009)
- Sir W. Ivor Jennings, The Law and the Constitution (University of London Press: London, 1959)
- Skender Skenderi (ed.), Si veproi Kuvendi i Republikës së Kosovës. Vëllimi I (4.12.1989 – 7.09.1990) (Printing press: Prishtinë, 2016)
- Slobodan Orlovic, “Ustavnopravni polozaj lokalne samouprave u Srbiji”. Zbornik radova Pravnog fakulteta u Novom Sadu 4 (2015)
- Slobodan Orlović*, Ustavno pravo (Pravni fakultet Univerziteta u Novom Sadu: Novi Sad, 2019)*
- Slobodan Samardzic (ed.), Norma i Odluka. Karl Smit i njegovi kriticari (Filip Visnjic: Beograd, 2001)
- Smiljko Sokol, Ustavno pravo (Narodne novine: Zagreb, 2009)
- Stavro Vinjau, E DREJTA KONSTITUCIONALE (SHTYPSHKRONJA ”Nikaj”: Tiranë, 1923)
- Subhi Jakupi, Rregllativa dhe parregullsitë zgjedhore (Instituti për Studime Politike dhe Ndërkombëtare: Shkup, 2017)
- Susan Rose-Ackerman and Peter L. Lindseth (eds), Comparative Administrative Law (Edward Elgar: UK and USA, 2010)
- Svetomir Skaric, Ustavno pravo. Osmo izdanje (KULTURA: Skopje, 2015)
- Svetomir *Škarić,* Ustavno pravo (Kultura: Skopje, 2009)
- Temistocle Martines, Diritto Costituzionale (Giuffrè Editore: Milano, 2011)
- Tom Gallagher, Outcast of Europe: The Ballkans 1789-1989 (Routledge: London and New York, 2001)
- Tony Waters and Dagmar Waters (eds.), Weber’s Rationalism and Modern Society: New Translations on Politics, Bureaucracy, and Social Stratification (Palgrave Maxmillan: Hamp-

shire, UK, 2015)
- Thomas Aquinas, De Regno: On Kingship Paperback Divine Providence Press: Milwaukee, 2014)
- Veselin Pavićević, Olivera Komar, Zlatko Vujović (eds.), Izbori i izborno zakonodavstvo u Crnoj Gori 1990 – 2004 (CEMI: Podgorica, 2005)
- Veselin Pavićević, Srđan Darmanović, Olivera Komar, Zlatko Vujović (eds.), Izbori i izborno zakonodavstvo u Crnoj Gori 1990 – 2006 (CEMI: Podgorica, 2007)
- Vinçenc Prenushi, NDËR LAMIJE TË DEMOKRACISË SË VËRTETË (Shtypshkronja Franciskane: Shkodër, 1922)
- Visar Morina, Florent Mucaj, Entela Nikaj, Jeton Shasivari dhe Luz Balaj, VETËQEVERISJA LOKALE: Shqyrtime teorike dhe krahasimore (Fondacioni-Konrad-Adenauer ne Republiken e Kosovës: Prishtinë, 2021)
- Vjekoslav Perica, Balkan idols: Religion and nationalism in Yugoslav states (Oxford University Press: Oxford, 2002)
- Vladimir Đuro Degan, Međunarodno pravo (Skolska Knjiga: Zagreb, 2011)
- Vladimir Goati, Izbori u SRJ od 1990 do 1998. Volja gradjana ili manipulacija. II DOPUNJENO IZDANJE (CENTAR ZA SLOBODNE IZBORE I DEMOKRATIJU: Beograd, 2001)
- Vojislav Simović, Komunalni sistem i komunalna politika (Naučna knjiga: Beograd, 1966)
- Wayne S. Vucinich, Jozo Tomasevich, Contemporary Yugoslavia: Twenty Years of Socialist Experiment (University of California Press: Berkeley and Los Angeles,1969)
- William Ivor Jennings, The Law and the Constitution, 5th edn (University of London Press: London, 1959)
- Willimoore Kendall, John Locke and the Doctrine of Majority-Rule (University of Illinois Press: Urbana, Illinois, 1959)
- Wojciech Sadurski (ed.), Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective (Kluwer Law International: The Hague, 2010)
- Young-Sun Hong, Welfare, Modernity, and the Weimar State (Princeton University Press: Princeton, 2016)
- Yves Beigbeder, "Referendum" Max Planck Encyclopedias of International Law [MPIL] (June 2011)
- Zdravko Zlokapa & Dušan Damjanović (eds.), Modeli organizacije lokalne samouprave: Slovenija, Hrvatska, Bosna i Hercegovina, Makedonija i Srbija (PALGO centar: Beograd, 2008)
- Židas Daskalovski, Walking on the Edge: Consolidating Multiethnic Macedonia, 1989-2004 (Globic Press: 2006)
- Zlatko Vujović (ed.), GRAĐANSKO NADGLEDANJE PARLAMENTARNIH I LOKALNIH IZBORA CRNA GORA 2020. FINALNI IZVJEŠTAJ (CEMI: Podgorica, 2020)

B. Artikuj:

- A. A. S. Zuckerman, "Quality and Economy in Civil Procedure: The Case for Commuting Correct Judgments for Timely Judgments Oxford Journal of Legal Studies Volume 14 Issue 3 (Autumn 1994)
- Adams, George Burton Adams, "The Descendants of the Curia Regis". The American Historical Review Vol. 13 Issue 1 (October 1907)
- Adan Nieto Martin, "Saudade of the constitution: The relationship Between constitutional and criminal Law in the European context". Journal of European Criminal Law Vol 10 N0. 1 (2019)
- Adem Beha, "Consociational Democracy and Political Engineering in Postwar Kosovo" Nationalities Papers Vol. 47 No. 4 (July 2019)

- Adem Beha, "Decentralisation in Kosovo: A Challenge to Deal With? Journal of Peace, Conflict and Development Vol. 1 Issue 17 (August 2011)
- Adolphe Thiers, "Le roi n'administre pas, ne gouverne pas, il règne". Le National - 4 Février 1830
- Adrian Kelly, "Catholic Action and the Development of the Irish Welfare State in the 1930s and 1940s". Archivium Hibernicum. Vol. 53 (1999)
- Akhil Reed Amar and Neal Kumar Katyal, "Executive Privileges and Immunities: The Nixon and Clinton Cases" Harvard Law Review. Vol. 108 No. 3 (January 1990)
- Alain Laquièze, "ADOLPHE THIERS THÉORICIEN DU RÉGIME PARLEMENTAIRE: Ses articles dans "Le National" en 1830" Revue Française d'Histoire des Idées Politiques No. 5 (1er semestre 1997)
- Alan Norton, (1991), "West European Local Government in Comparative Perspective". Në Richard Batley and Gerry Stoker (eds.), Local Government in Europe. Trends and Developments (Macmillan: Houndsmills, 1991)
- Alan Norton, "What East European Democracies Might Learn from the West". Në Andrew Coulson (ed.), Local Government in Eastern Europe. Establishing Democracy at the Grassroots (Edward Elgar: Aldershot, 1995)
- Alan Norton, A. (1985). Local Government in Other Western Democracies. Introductory Paper No 4. Institute of Local Government Studies (University of Birmingham: Birmingham, 1985)
- Alastair Mowbray, "A New Strasbourg Approach to the Legal Consequences of Interim Measures Human Rights Law Review Volume 5 Issue 2 (2005)
- Alberto Alesina & David Dollar, "Who Gives Foreign Aid to Whom and Why?" Journal of Economic Growth Volume 5, No. 1 (March 2000)
- Alex Schwartz and Melanie Janelle Murchison "Judicial Impartiality and Independence in Divided Societies: An Empirical Analysis of the Constitutional Court of Bosnia – Herzegovina" Law & Society Review, Vol. 50, No. 4 (2016)
- Alexander Cooley, John Heathershaw, and J. C. Sharman "The Rise of Kleptocracy: Laundering Cash, Whitewashing Reputations". Journal of Democracy, Vol. 29 No. 1 (Janury 2018)
- Alexander H. Trechsel and Hanspeter Kriesi, "Switzerland: the referendum and initiative as a centrepiece of the political system". Në Pier Vincenzo Uleri & Michael Gallagher (eds.), The Referendum Experience in Europe. 6th Edition (Palgrave Macmillan Basingstoke, 1996)
- Alfred P. Rubin, "The International Legal Effects of Unilateral Declarations". American Journal International Law Vol. 71 No. 1 (1977)
- Alfred Stepan and Cindy Skach, "Constitutional Frameworks and Democratic Consolidation. Parliamentarism versus Presidentialism". World Politics.Vol. 46 No. 1 (October 1993)
- Amos Perlmutter, "The Praetorian State and the Praetorian Army: Toward a Taxonomy of Civil-Military Relations in Developing Polities" Comparative Politics Vol. 1, No. 3 (April 1969)
- Amy J. Weisman, "Separation of Powers in Post-Communist Government: A Constitutional Case Study of the Russian Federation". American University International Law Review Vol. 10 Issue 4 (1995)
- Ana S. Trbovich, A Legal Geography of Yugoslavia's Disintegration (Oxford University Press: Oxford, 2008)
- András Jakab and Johanna Frölich, "The Constitutional Court of Hungary". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), Comparative Constitutional Reasoning
- András Sajó, "Les autorités indépendantes". Në Michel Troper et Dominiques et Chagnollaud (eds.), Traité international de droit constitutionnel. Tome 2: Distribution des pouvoirs (Dalloz: Paris, 2012)
- Andrea Lorenzo Capussela, "A Critique of Kosovo's Internationalized Constitutional Court". European Diversity and Autonomy Papers. EDAP 02/2014

- Andreas Calogeropoulos, "The Hellenic Republic". Në Lucas Prakke and Constantijin Kortmann (eds.), Constitutional Law of 15 EU Member States (Kluwer Legal Publishers: Deventer, The Netherlands, 2004)
- Andrew Heard, "Just What Is a Vote of Confidence? The Curious Case of May 10, 2005". Canadian Journal of Political Science/Revue canadienne de science politique. Vol. 40 (2) (June 2007)
- Andrew Linrott, "Aristotle and the Mixed Constitution". Në Roger Brock and Stephen Hodkinson (eds.), Alternatives to Athens: Varieties of Political Organization and Community in Ancient Greece (Oxford, 2002 online edn, Oxford Academic, 1 Jan. 2010)
- Angelo Metzidakis, "Victor Hugo and the Idea of the United States of Europe". Nineteenth-Century French Studies Vol. 23 No. 1/2 (Fall-Winter 1994-95)
- Anna Gamper, "A Global Theory of Federalism": The Nature and Challenges of a Federal State". German Law Journal Vol. 6 No. 10 (2005)
- Anne Peters and Ulrich K Press, "International relations and international law". Në Mark Tushnet, Thomas Fleiner and Cheryl Saunders (eds.), Rutledge Handbook of Constitutional Law (Routledge: Abongdon, 2012)
- Anson D. Morse, "What is a Party?" Political Science Quarterly Vol. 11 No. 1 (March 1896)
- Anton-Hermann Chroust, "The Philosophy of Law of St. Augustine". The Philosophical Review Vol. 53, No. 2 (Mar., 1944)
- Antony Best, Jussi Hanhimaki, Joseph A. Maiolo, Kirsten E. Schulze, International History of the Twentieth Century and Beyond (Routledge: New York, 2015)
- Anthony King and Nicholas Allen, " 'Off With Their Heads': British Prime Ministers and the Power to Dismiss". British Journal of Political Science. Vol. 40 No. 2 (2010)
- Arend Lijphart, "Consociational Democracy". World Politics Vol. 21 No. 2 (1969)
- Arend Lijphart, "Constitutional Design for Divided Societies" Journal of Democracy Vol. 15 No. 2 (2004)
- Arundhati Virmani, "Regionalism in France" Proceedings of the Indian History Congress Vol. 48 (1987)
- August Thor Aranson, "Constitutionalism: Popular Legitimacy of the State?". Në Martin Scheinin (ed.), Welfare State and Constitutionalism - Nordic Perspectives (Nordic Council of Ministers: Copenhagen, 2001)
- Aviva A. Orenstein, "Presidential Immunity from Civil Liability: Nixon v. Fitzgerald" Cornell Law Review. Vol. 68 No. 2 (January 1983)
- Bäck, and Patrick Dumont, "Making the First Move: A Two-Stage Analysis of the Role of Formateurs in Parliamentary Government Formation" Public Choice. Vol. 135 No. 3-4 (January 2008)
- Barry J. Ryan, "Policing the state of exception in Kosovo". Në Aidan Hehir (ed.), Kosovo, Intervention and Statebuilding: The International Community and the Transition to Independence (Routledge: London and New York, 2010)
- Ben Bagwell, "Yugoslavian Constitutional Questions: Self-Determination and Secession of Member Republics" Georgia Journal of International and Comparative Law Vol. 21 No. 3 (1991)
- Benjamin Kaplan, Arthur T. von Mehren and Rudolf Schaefer, "Phases of German Civil Procedure I" Harvard Law Review Vol. 71 No. 7 (May, 1958)
- Bernard Stirn "Constitution et droit administratif" Les Nouveaux Cahiers du Conseil constitutionnel Vol. 4 No 37 (2012)
- Bruce Ackerman, "Good-bye, Montesquieu". Në Susan Rose-Ackerman and Peter L. Lindseth (eds), Comparative Administrative Law (Edward Elgar: UK and USA, 2010)
- Burke Shartel, "Federal Judges: Appointment, Supervision, and Removal: Some Possibilities under the Constitution". Michigan Law Review. Vol. 28 No. 5 (March 1930)
- C. J. Friedrich, "Political Reconstruction. Karl Loewenstein". The Journal of Modern His-

tory Vol. 20 No. 3 (Sep., 1943)
- Carl T. Dahlman, "Faire frontière dans la paix: le Kosovo et la décentralisation de la concurrenceethno-politique" L'Espace Politique [Online], 33 | 2017-3
- Carlo Salone, "Questioning New regionalism from an Italian perspective, or the resistible rise of Italian regions" Pôle Sud Vol. 1 No. 46 (2017)
- Carsten Jacob Humlebæk, "Political and territorial construction of regional and national identities in Spain since 1978" L'Europe en Formation Vol. 1 No. 379 (2016)
- Charles Grove Haines, "Ministerial Responsibility Versus the Separation of Powers" The American Political Science Review. Vol. 16 No. 2 (May 1922)
- Charles Sumner Lobingier, "Rise and Fall of Feudal Law". Cornell Law Review Vol. 18 Issue 2 (February 1933)
- Chemerinsky, Erwin (2001) 'Against Sovereign Immunity'. Stanford Law Review. Symposium: Shifting the Balance of Power? The Supreme Court, Federalism, and State Sovereign Immunity Vol. 53 No 5 (May 2001)
- Cheryl Saunders and Adrienne Stoner, "The Hight Court of Australia". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), Comparative Constitutional Reasoning
- Christian J. Tams, "Interim Orders by the European Court of Human Rights – Comments on Mamatkulov and Abdurasulovic v. Turkey" Zeitschrift für ausländisches öffentliches Recht und Völkerrecht 63 (2003)
- Christian Lucky, "A Comparative Chart of Presidential Powers in Eastern Europe" East European Constitutional Review. (Double Issue) Vol. 2 No. 4 (Fall 1993) dhe Vol. 3 No. 1 (Winter 1993)
- Christina Binder and Constanze, "A capability perspective of indigenous autonomy". Oxford Development Studies Vol. 44 Issue 3 (2016)
- Christina Isabel Zuber and Jelena Džankic, "Serbia and Montenegro: From Centralization to Secession and Multi-ethnic Regionalism". Në Arjan H. Schakel (ed.), Regional and national elections in Eastern Europe: territoriality of the vote in ten countries (Palgrave Macmillan: London, 2017)
- Christina Morus, "The SANU Memorandum: Intellectual Authority and the Constitution of an Exclusive Serbian 'People'" Communication and Critical/Cultural Studies Vol. 4 Issue 2 (2007)
- Christopher Clague, Suzzanne Gleason, Stephen Knack, "Determinants of Lasting Democracy in Poor Countries: Culture, Development, and Institutions". The ANNALS of the American Academy of Political and Social Science Vol. 573 No. 1 (2001)
- Christopher May, "The Rule of Law: Athenian Antecedents to Contemporary Debates" Vol. 4 Issue 2 (2012) 4 Hague Journal on the Rule of Law (September 2012)
- Colin Warbrick, "Kosovo: The Declaration of Independence" International and Comparative Law Quarterly. Volume 57 Issue 03 (July 2008)
- Collins Lawrence, "Provisional and protective measures in international litigation" Collected Courses of the Hague Academy of International Law Vol. 234 No. 3 (1992)
- Cristina Barbieri and Michelangelo Vercesi, "The Cabinet: A Viable Definition and its Composition in View of a Comparative Analysis". Government and Oposition Vol. 48 No. 4 (October 2013)
- Dale E. Miller, "The Place of Plural Voting in Mill's Conception of Representative Government". The Review of Politics Vo. 77 No. 3 (2015)
- Damir Velički, "Koncept" borbene demokracije "u SR Njemačkoj". Politička misao Vol. 58 No. 4 (2007)
- Daniel Bell and Leon Dennen, "The System of Governments in Exile". The ANNALS of the American Academy of Political and Social Science Vol. 232, A Challenge to Peacemakers (March 1944)
- Daniel C. Villanueva, "Richard von Coudenhove-Kalergi's" Pan-Europa" as the Elusive

”Object of Longing” Rocky Mountain Review of Language and Literature Vol. 59 No. 2 (2005)
- Daniel Diermeier, Hülya Eraslan and Antonio Merlo, “A Structural Model of Government Formation” Econometrica. Vol. 71 No. 1 (January 2003)
- Daniel Smilov, “The Judiciary: The Least Dangerous Branch?”. Në Michel Rosenfeld and András Sajó (eds.), The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law (Oxford University Press: Oxford, 2012)
- Darcy K. Leach, “The Iron Law of What Again? Conceptualizing Oligarchy Across Organizational Forms”, Sociological Theory, Vol. 23, No. 3 (September 2005)
- David P. Fidler, “A Kinder, Gentler System or Capitulations? International Law, Structural Adjustment Policies, and the Standard of Liberal, Globalized Civilization”. Texas International Law Journal Vol. 35 No. 3 (July 2000)
- David Pion-Berlin and Harold Trinkunas, “Civilian Praetorianism and Military Shirking During Constitutional Crises in Latin America” Comparative Politics Vol. 42, No. 4 (July 2010)
- David Torrance, “Taking the border out of politics – the Northern Ireland referendum of March 1973”. The Constitution Unit November 21, 2019
- Dierk Waiter, “A Military Revolution? Prussian Military Reforms before the Wars of German” Unification FORSVARSSTUDIER 2/2001, Oslo)
- Dieter Grimm, “Integration by Constitution” International Journal of Constitutional Law Vol. 3 Issue 2-3 (May 2005)
- Dieter Grimm, “Types of Constitutions”. Në Michel Rosenfeld and András Sajó (eds.)., The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law (Oxford University Press: Oxford, 2012)
- Donald H.J. Hermann, “Max Weber and the Concept of Legitimacy in Contemporary Jurisprudence” De Paul Law Review Vol. 33 No. 1 (Fall 1983)
- Donald P. Kommers, “German Constitutionalism: A Prolegomenon”. Emory Law Journal, Vol. 40, No. 1 (1991)
- Donald P. Kommers ”The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany. Second Edition’ (Durham and London: Duke University Press: Durham and London, 1997)
- Donatella Campus and Gianfranco Pasquino, Gianfranco, “Leadership in Italy: The Changing Role of Leaders in Elections and in Government’. Journal of Contemporary European Studies. Vol. 14 No. 1 (2006)
- Donglan Huang, “The Concept of” Self-Government” across Cultures: From the Western World to Japan and China” Cultura. International Journal of Philosophy of Culture and Axiology Vol. 15 No. 2 (2018)
- Dragan Đukanović, “Izborni sistemi u zemljama nekadašnje Jugoslavije”. *Međunarodni problemi* Vol. LVIII, br. 4 (Decembar 2006)
- Dragoslav Janković, Jugoslovensko pitanje i Krfska deklaracija 1917 godine (Savremena administracija: Beograd, 1967)
- Dragutin Papović, “ADMINISTRATIVNO-TERITORIJALNA PODJELA I LOKALNA SAMOUPRAVA U CRNOJ GORI 1945-1963”. Montenegrin Journal for Social Sciences Vol. 4 Issue 1 (2020)
- Dragutin Pavličević, “A review of the historical development of the Republic of Croatia” GeoJournal Vol. 38, No. 4, (April 1996)
- Dren Doli & Fisnik Korenica, “Kosovar Constitutional Court’s Jurisdiction: Searching for Strengths and Weaknesses” German Law Journal Vol. 11 No. 7-8 (2010)
- Dren Doli dhe Fisnik Korenica, “The Consociational System of Democracy in Kosovo: Questioning Ethnic Minorities’ Special Status in Kosovo’s Constitutional Regime”, International Journal of Public Administration Vol. 36 No. 9 (2013)
- Droit Constitutionnel et Institutions Politiques. By ANDRÉ HAURIOU. (Paris: Editions

Montchréstien, 1966. Pp. iv, 826.)". Political Research Quarterly Vol. 19 Issue 2 (1966)
- Duško Lozina i Josipa Jagnjić, "Razvoj lokalne samouprave u Republici Hrvatskoj" Zbornik radova Pravnog fakulteta u Splitu, God. 58, No. 2 (2021)
- Edward M. Harris, "Antigone the Lawyer, or the Ambiguities of Nomos". Në Edward Harris and Lene Rubinstein (eds), The Law and Courts in Ancient Greece (Duckworth: London, 2004)
- Elizabeth Asmis, "A New Kind of Model: Cicero's Roman Constitution in 'De republica'". The American Journal of Philology Vol. 126, No. 3 (Autumn, 2005)
- Elvio Baccarini and Viktor Ivankovic, "Mill's case for plural voting and the need for balanced public decisions". Prolegomena Vol. 14 No. 2 (2015)
- Ellis Krauss and Benjamin Nyblade"Presidentialization' in Japan? The Prime Minister, Media and Elections in Japan". British Journal of Political Science. Vol. 35 No 2 (April 2005)
- Emilio C. Viano, "Plea Bargaining in the United States: a Perversion of Justice". Revue internationale de droit pénal Vol. 83 No. 1-2 (2012)
- Emilio Crosa, "Diritto costituzionale". Novissimo Digesto Italiano Vol. V (Tipografia Cane & Durante: Torino, 1968)
- Emily Hay, "International (ized) Constitutions and Peacebuilding". Leiden Journal of International Law Vol. 27 No. 1 (2014)
- Emmanuel-Joseph Sieyès, (1748-1836), Qu'est-ce que le Tiers état? ([Reprod.]) [par Sieyès]. 1789
- Enver Hasani and Getoar Mjeku, "International(ized) Constitutional Court: Kosovo's Transfer of Judicial Sovereignty" Vienna Journal on International Constitutional Law Vol. 13, Issue 4 (December 2019)
- Enver Hasani, "Basic Features of the Constitutional System in Kosovo". Në Rainer Arnold, Jose Ignacio Martinez-Estay (eds.), Rule of Law, Human Rights and Judicial Control of Power. Some Reflections from National and International Law (SPRINGER International Publishing AG: Switzerland, 2017)
- Enver Hasani, "Judicial Review of Democracy. Maintenance of Democracy as a Functionalist Mission in the Jurisprudence of the Constitutional Court of Kosovo" Südosteuropa Vol. 68 No. 4 (2020)
- Enver Hasani, "Rasti i Asociacionit serb në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës" E Drejta/Law Viti XLI - Nr. 1-4 (2015)
- Enver Hasani, "Self-Determination under the Terms of the 2002 Union Agreement between Serbia and Montenegro: Tracing the Origins of Kosovo's between Serbia and Montenegro". Chicago Kent Law Review Vol. Issue 1 (December 2004)
- Enver Hasani, "Veçoritë themelore të sistemit kushtetues në Kosovë". E DREJTA/LAW Vol. XL No.1-4 (2014)
- Enver Hasani, Self-Determination, Territorial Integrity and International Stability: The Case of Yugoslavia (National Defense Academy Institute for Peace Support and Conflict Management/PfP-Consortium of Defense Academies and Security Studies Institutes: Vienna, 2003)
- Eoin O'Malley, "The Power of Prime Ministers: Results of an Expert Survey". International Political Science Review/Revue internationale de science politique. Vol. 28 No. 1 (January 2007)
- Eric Stein, "International Law in Internal Law: Towards Internationalisation of Central – Estern European Constitutions". American Journal of International Law Vol. 88 No. 3 (July 1994)
- Eric Suy, "Unilateral Acts of States as a Source of International Law: Some New Thoughts and Frustrations". Në Olivier Corten, Pierre Klein, Anne Lagerëall, et al., Droit du pouvoir, pouvoir du droit: Mélanges offerts à Jean Salmon (Bruylant: Brussels, 2007)
- Ernest Hambloch, "The New Régime in Brazil". Foreign Affairs Vol. 16, No. 3 (Apr., 1938)
- Ernest Young, "Federalism as a Constitutional Principle" University of Cincinnati Law Re-

view Vol. 83 No. 4 (August 2015)
- Ester Herlin-Karnell, "The Power of Comparative Constitutional Law Reasoning in European Criminal Law Procedure". Vienna Journal on International Constitutional Law Vol. 13 No. 1 (2019)
- Etem Aziri, "Izborni sistemi i izboriu Republici Makedoniji:prošlost, sadašnjost iizazovi za budućnost". Politicke Perspektive: casopis za istrazivanje politike. Vol. 3 No. 1 (2013)
- Evan Bass, "Ex-Head of State Immunity: A Proposed Statutory Tool of Foreign Policy" The Yale Law Journal Vol. 97 No. 2 (December 1987)
- Ezra N. Suleiman, "Presidentialism and Political Stability in France". Në Juan J. Linz and Arturo Valenzuela (eds.), The Failure of Presidential Democracy, Vol. 1 (The Johns Hopkins Univesity Press: Baltimore Maryland and London, 1994)
- Fábio Konder Comparato, "The Economic Order in the Brazilian Constitution of 1988" The American Journal of Comparative Law Vol. 38, No. 4 (Autumn, 1990)
- Fabio Raimondi, "Republic and Constitution in Machiavelli's Discourses". Në Diogo Pires Aurélio and Andre Santos Campo (eds.), Machiavelli's Discourses on Livy: New Readings (Brill: Leiden, 2021)
- Fabrizio Gilardi, "Policy credibility and delegation to independent regulatory agencies: a comparative empirical analysis". Journal of European Public Policy Vol. 9 No. 6 (2002)
- Ferdinand Lassalle, "On the Essence of Constitutions" (Speech Delivered in Berlin, April 16, 1862). Fourth International Vol. 3 No. 1 (January 1942)
- Ferdo Čulinović, Jugoslavija između dva rata. Vol. I (JAZU: Zagreb, 1961)
- Feroz Ahmad, "Ottoman Perceptions of the Capitulations: 1800–1914. Journal of Islamic Studies Vol. 11 No. 1 (January 2000)
- Fisnik Korenica & Dren Doli, "The Politics of Constitutional Design in Divided Societies: The Case of Kosovo" Croatian Yearbook of European Law and Policy 6, no. 6 (2010)
- Francis Hamon, "Le statut des partis politiques". Në Dominique Chagnollaud, Michel Troper, Traité international de droit constitutionnel. Distribution des pouvoirs. Tome 2 (Traités Dalloz: Paris, 2012)
- Francisco Jorge Rodríguez Gonzálvez, "Exploring the Constitutional Possibilities for a European Social Model. Some Common Constitutional Traditions between Liberalism and Social Intervention". L'Europe en Formation Vol. 2 No. 372 (2014)
- François Houdecek, "Training and Teaching of Conscripts During the Boulogne Camp" Napoleonica La Revue Vol. 32 No 2 (2018)
- Frank Stark, "The Prime Minister as Symbol: Unifier or Optimizer?" Canadian Journal of Political Science/Revue canadienne de science politique. Vol. 6 No. 3 (1973)
- Franz Michael, "The Significance of Puppet Governments". Pacific Affairs Vol. 12 No. 4 (December, 1939)
- Frédéric Lépine, "A Journey through the History of Federalism Is Multilevel Governance a Form of Federalism?" L'Europe en Formation Vol. 1 No. 363 (2012)
- Gary J. Jacobsohn, "Abraham Lincoln 'On This Question of Judicial Authority': the Theory of Constitutional Aspiration" Political Reseacrh Quarterly Volume 36 Issue 1 (1983)
- Gary W. Cox, "Was the Glorious Revolution a Constitutional Watershed?" The Journal of Economic History Vol. 72 No. 3 (September 2012)
- George C. Guins, "Moscow's European Satellites". The Annals of the American Academy of Political and Social Science Vol. 271, (Sep., 1950)
- George Sutherland, "The Internal and External Powers of the National Government". The North American Review. Vol. 191, No. 652 (March 1910)
- Gerald Harriss, "Political Society and the Growth of Government in Late Medieval England". Past & Present No. 138 (February 1993)
- Giancarlo Rolla and Tania Groppi, "Between Politics and the Law: The Development of Constitutional Review in Italy". Në Wojciech Sadurski (ed.), Constitutional Justice East and

West. Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in A Comparative Perspective (The Hague Kluwer Law International: The Hague, 2010)
- Girard Albert, "Joseph Dedieu. Montesquieu et la tradition politique anglaise en France. Les sources anglaises de l'Esprit des Lois, 1909". Revue d'histoire moderne et contemporaine, Tome 14 No. 1 (1910)
- Glen S. Krutz and Jeffrey S. Peake, "The Changing Nature of Presidential Policy Making on International Agreements". Presidential Studies Quarterly. Vol. 36 No. 3 (September 2006)
- Gordana Siljanovska-Davkova, "Legal and Institutional Framework of Local Self-Government in the Republic of Macedonia" LEX LOCALIS - JOURNAL OF LOCAL SELF-GOVERNMENT Vol. 7, No. 2 (April 2009)
- Hans Kelsen, "Judicial Review of Legislation: A Comparative Study of the Austrian and the American Constitution". The Journal of Politics Vol. 4 No. 2 (May, 1942)
- Hans Kelsen, "La garantie juridictionnelle de la constitution (La justice constitutionnelle)". Revue du droit public et de la science politique en France et a l' etranger XXXV (Librarie General de Droit et de Jurisprudence, Paris 1928)
- Hans Kelsen, Wer soll der huter der verfassung sein?, (Dr. Walther Rothschild: Berlin-GruNewald, 1931)
- Hans STARK L'armée: grande muette ou grande inconnue? Politique étrangère Vol. 55, No. 4 (HIVER 1990)
- Hans-Peter Schaub, "Maximising Direct Democracy by Popular Assemblies or by Ballot Votes" Swiss Political Science Review Vol. 18 Issue (September 2012)
- Harold H. Bruff, H., Harold, "The Incompatibility Principle". Administrative Law Review. Vol. 59 No. 2 (Spring 2007)
- Harry N. Scheiber, "Federalism and Legal Process: Historical and Contemporary Analysis of the American System" Law & Society Review Vol. 14, No. 3, Contemporary Issues in Law and Social Science (Spring, 1980)
- Henry Paul Monaghan, "The Confirmation Process: Law or Politics". Harvard Law Review. Vol 101 No. 6 (1988)
- Henry Roussillon, "Le Big Bang et la pyramide!". Në Henry Roussillon, Xavier Bioy et Stephane Mouton (eds.), Le nouveaux objets du droit constitutionnel Presses de l'Universite des sciences sociales de Toulouse: Toulouse, 2006)
- Herbert W. Rice, "Book Review: Corwin: Constitutional Revolution, Ltd". Marquete Law Review Vol. 26 No. 2 (February 1942)
- Herman Belz, "Abraham Lincoln and American Constitutionalism" The Review of Politics Vol. 50 No. 2 (Spring, 1988)
- Herman Belz, "The 'Philosophical Cause' of 'Our Free Government and Consequent Prosperity': The Problem of Lincoln's Political Thought" Journal of the Abraham Lincoln Association Volume 10 No. 1 (1988)
- Howard Schweber and Jennifer L. Brookhart, "The Supreme Court of the United States". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), Comparative Constitutional Reasoning
- Hugo Cyr and Monica Popescu, "The Supreme Court of Canada". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), Comparative Constitutional Reasoning
- Jacqueline Stevens, "The Reasonableness of John Locke's Majority: *Property Rights, Consent*, and Resistance in the Second Treatise ". Political Theory Vol. 24 No. 3 (August 1996)
- Jacques Caillosse, "Les *fonctions* socio-politiques de l'*Etat*". Në Michel Troper et Dominiques et Chagnollaud (eds.), Traité international de droit constitutionnel. Tome 3: Suprématie de la Constitution (Dalloz: Paris, 2012)
- James Bryce, "Flexible and Rigid Constitutions". Studies in History and Jurisprudence Vol. I (1901)
- James H. Svara, "Effective Mayoral Leadership in Council-Manager Cities: Reassessing the

Facilitative Model" National Civic Review Vol. 92 No. 2 (Summer 2003)
- James H. Svara, "The Shifting Boundary between Elected Officials and City Managers in Large Council-Manager Cities" Public Administration Review Vol. 59 No. 1 (Jan. - Feb., 1999)
- James W. Garner, "Cabinet Government in France'. The American Political Science Review. Vol. 8 No. 3 (August 1914)
- Janelle Greenberg, "Our Grand Maxim of State, 'The King Can Do No Wrong'" History of Political Thought Vol. 12 No. 2 (Summer 1991)
- Jean Charpentier, "Engagements unilatéraux et engagements conventionnels: Différences et convergences". Në Jerzy Makarczyk (ed.), Theory of International Law at the Threshold of the 21st Century: Essays in Honour of Krzysztof Skubiszeëski (Kluwer Law International: The Hague, 1996)
- Jean Didier Sicault, "Du caractère obligatoire des engagements unilatéraux en droit international public". Revue Général de Droit International Public Vol. 83 (1979)
- Jean-Louis Mestre, "Le emplois initiaux de l'expression 'droit constitutionnel'", « Revue française de droit constitutionnel Vol. 3 No. 55 (2003)
- Jeffery Gray Jacobsohn, Jeffrey Gary, "An unconstitutional constitution? A comparative perspective'. International Journal of Counstitutional Law. Vol. 4 No. 3 (2006)
- Jeffrey Goldsworthy, "Constitutional Interpretation". Në Michel Rosenfeld and András Sajó (eds.), The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law
- Jennifer L. Long, "How to Sue the President: A Proposal for Legislation Establishing the Extent of Presidential Immunity" Valpo University Law Review Vol 30 No. 1 (Fall 1995)
- Jennifer L. Mnookin, "Review: Uncertain Bargains: The Rise of Plea Bargaining in America Reviewed Work: *Plea Bargaining's Triumph: A History of Plea Bargaining in America* by George Fisher". Stanford Law Review Vol. 57, No. 5, 2005 Stanford Law Review Symposium: The Civil Trial: Adaptation and Alternatives (April, 2005)
- Jenny Gesley, "Family Voting as a Solution to Low Fertility? Experiences from France and Germany". In Custodia Legis. Law Librarians of Congress (April 19, 2018)
- Jered B. Carr, "What Have We Learned about the Performance of Council-Manager Government? A Review and Synthesis of the Research" Public Administration Review Vol. 75 No. 5 (September/October 2015)
- Jerzy J. Wiatr Political Leadership Between Democracy and Authoritarianism Comparative and Historical Perspectives (Verlag Barbara Budrich Opladen: Berlin, Toronto, 2022)
- Jerzy J. Wiatr, "Political Parties, Interest Representation and Economic Development in Poland". The American Political Science Review Vol. 64, No. 4 (Dec., 1970)
- Joanne Barkan, "Plutocrats at Work: How Big Philanthropy Undermines Democracy". Social Research Vol. 80 No. 2 (Summer 2013)
- John Bell, "Sources of Law". Cambridge Law Journal Vol. 77 No. 1 (March 2018)
- John D. Huber and Cecelia Martinez-Gallardo, "Replacing Cabinet Ministers: Patterns of Ministerial Stability in Parliamentary Democracies". The American Political Science Review. Vol. 102 No. 2 (2010)
- John Horne, "1848 and the Language of Politics". Saothar Vol. 25 (2000)
- John Tunheim, "Rule of Law and the Kosovo Constitution". Minnesota Journal of International Law Vol. 18 No. 2 (2009)
- Johnathan O'Neill, "Carl J. Friedrich's Legacy: Understanding Constitutionalism as a Political System". The European Legacy Vol. 14 Issue 3 (2019)
- Jorge Urdánoz, "John Stuart Mill and proportional representation. A misunderstanding". Political Science Vol. 71 No. 2 (2019)
- José Antonio Cheibub & Bjørn Erik Rasch, "Constitutional parliamentarism in Europe, 1800–2019" West European Politics Vol. 45 No. 3 (2022)
- Josip Vrana, "Da li je sačuvan original isprave Kulina bana, Paleografijsko-jezična studija o

primjercima isprave iz g. 1189". Radovi Staroslavenskog Instituta Vol. 2 No. 2 (1955)
- Jovan Radulović, The problems of regional development in Montenegro. Applied Studies in Agribusiness and Commerce Vol. 7 No. 2-3 (2013)
- Joyce Lee Malcolm, "Doing No Wrong: Law, Liberty, and the Constraint of Kings" Journal of British Studies Vo. 38 No. 2 (1999)
- Juan E. Mendez, "Constitutionalism and Transitional Justice". Në Michel Rosenfeld and Andras Sajo (eds.), The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law (Oxford University Press: Oxford, 2012)
- Juan Pablo Fusi, "2. Regionalism and nationalism in contemporary Spain" RSA Journal Vol. 142 No. 5452 (August/September 1994)
- Judith Wise, "Dissent and the Militant Democracy: The German Constitution and the Banning of the Free German Workers Party". The University of Chicago Law School Roundtable Vol. 5 Isssue 1 (1998)
- Julien Barroche, "Maurice Hauriou (1856–1929)". Në Oliver Descamps & Rafael Domingo (eds.), Great Christian Jurists in French History (Cambrdge University Press: Cambridge: 2019)
- Juliet Kaarbo, "Prime Minister Leadership Styles in Foreign Policy Decision-Making: A Framework for Research". Political Psychology. Vol. 18 No. 3 (September 1997)
- Juraj Medzihorsky, "Rethinking the D'Hondt method". Political Research Exchange Vol. 1 Issue 1 (2019)
- K. M. Schonfeld, "Un jeu de patience: Montesquieu, la bouche et le silence de la loi". Revue du Nord. Tome 52, No. 204 (Janvier-mars 1970)
- Karl Loewenstein, "Constitutions and Constitutional Law in the West and in the East". The Indian Journal of Political Science Vol. 30, No. 3 (July-September 1969)
- Karl Smit, Tri vrste pravnonaucnog misljenja (Biblioteka Parerga: Beograd, 2003)
- Karl Zemanek, "Unilateral Legal Acts Revisited", në Karel Wellens, ed., International Law: Theory and Practice Essays in Honour of Eric Suy. (The Hague: Martinus Nijhoff, 1998)
- Katalin Kelemen, "Appointment of Constitutional Judges in a Comparative Perspective – with a Proposal for a New Model for Hungary". Acta Juridica Hungarica Vol. 54 No. 1 (2013)
- Katarina Spehnjak, "Brionski plenum'- odjeci IV. sjednice CK SKJ iz srpnja 1966. godine u hrvatskoj političkoj javnosti". Časopis za suvremenu povijest Vol. 31 No. 3 (1999)
- Katz, Richard S. Katz, "Early Voting and Elections". Në Democracy and Elections (New York, 1997 online edn, Oxford Academic, 22 Sept. 2011)
- Kevin J. McMahon, "Presidents, Political Regimes, and Contentious Supreme Court Nominations: A Historical Institutional Model". Law and Social Inquiry, Vol. 32 Issue 4 (2007)
- Konrad Lachmayer, "The Austrian Constitutional Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), Comparative Constitutional Reasoning
- Latinka Perović, Kraljevina Srba, Hrvata i Slovenaca (1918–1929)/Kraljevina Jugoslavija (1929–1941): nastanak, trajanje i kraj (Pa emër të botuesit: Beograd, 2015)
- Laver, Michael Laver, "Governmental Politics and the Dynamics of Multiparty Competition". Political Research Quarterly. Vol. 61 No 3 (2008)
- Lazar Nikolić, "Ethnic Prejudices and Discrimination: The Case of Kosovo". Në Florian Bieber, Židas Daskalovski (eds.), Understanding the war in Kosovo (Psychology Press: London, 2003)
- Leon Duguit, "La separation des pouvoirs et l'Assemblee nationale de 1789". Revue d' Economie Politique. Vol. 7 No. (1893)
- Liav Orgad, "The preamble in constitutional interpretation". International Journal of Constitutional Law Vol. 8 No. 4 (2010)
- Lisa L. Martin, "The President and International Commitments: Treaties as Signaling Devices". Presidential Studies Quarterly. Vol. 35 No. 3 (September 2005)
- Ljubica JANČEVA, "THE PRINCIPLES OF ASNOM AND THE CONSTITUTIONAL

HISTORIC LEGACY FOR THE ”FRAMEWORK” REPUBLIC OF MACEDONIA”. Politeja No. 30, Macedonia in 20th and 21st century (2014)
- Lo Littler, “Meritocracy as Plutocracy: The Marketising of ‘Equality’ Under Neoliberalism”. New Formations Nos. 80 and 81 (Winter, 2013)
- Louis Aucoin, “Views from the Field On Constitution Writing: The Case of Kosovo (Interview)”. PRAXIS: The Fletcher Journal of Human Security XXIII, (2008)
- Louis Fisher, “The Law Treaty Negotiation: A Presidential Monopoly?” Presidential Studies Quarterly. Vol. 38 No. 1 (March 2008)
- Luciano Vandeli, “Formes d’Etats: Etat regional, Etat decentralize”. Në Michel Troper et Dominiques et Chagnollaud (eds.), Traité international de droit constitutionnel. Tome 2: Distribution des pouvoirs (Dalloz: Paris, 2012)
- Luciano Bardi and Peter Mair, “The Parameters of Party Systems” Party Politics Vol. 14 Issue 2 (2008)
- Lucius Ellsworth Thayer, “The Capitulations of the Ottoman Empire and the Question of their Abrogation as it Affects the United States” The American Journal of International Law Vol. 17 No. 2 (April 1923)
- Lukas van den Berge, “Montequieu and Judicial Review of Proportionality in Administrative Law: Rethinking the Separation of Powers in the Neoliberal Era” European Journal of Legal Studies {Vol. 10 No. 1 (2017)
- Lynette B. Wrenn, “Commission Government in the Gilded Age: The Memphis Plan” Tennessee Historical Quarterly Vol. 47, No. 4 (Winter 1988)
- M. P. GOLDING, “KELSEN AND THE CONCEPT OF “LEGAL SYSTEM” Archiv für Rechts- und Sozialphilosophie Vol. 47 (1961)
- Manfred F.R. Kets de Vries, “The spirit of despotism: Understanding the tyrant within” Human Relations Vol. 59 No. 2 (February 2006)
- Manfred Gerstenfeld, “The Deep Roots of Anti-Semitism in European Society”. Jewish Political Studies Review Vol. 17, No. 1/2 (Spring 2005)
- Marc Debus, “Pre- Electoral Commitments and Government Formation” Public Choice. Vol. 138 No. 1-2 (January 2009)
- Marc Weller, “The Rambouillet Conference on Kosovo” International Affairs Volume 75, Issue 2 (April 1999)
- Marco Goldoni, “Introduction to the material study of global constitutional law”. Global Constitutionalism Vol. 8 No. 1 (2019)
- Michael Krykov, “Self-Determination From Marx to Mao” Ethnic and Racial Studies Vol. 19 No. 2 (April 1996)
- Mario Turchetti, “Despotism’ and ‘Tyranny’. Unmasking a Tenacious Confusion”. European Journal of Political Theory, Vol. 7 No. 2 (2008)
- Mark Catcher, “Regulation after delegation: independent regulatory agencies in Europe” Journal of European Public Policy Vol. 9 No. 6 (2002)
- Marko Prelević, “Titu sam rekao ‘Crnogorci jesu Srbi’. A on mi je odgovorio: ‘Dobro, ali nama sada treba Republika’…”: Šta je stvarno mislio Milovan Đilas”. NEDELJNIK 19/07/2020
- Matt Qvortrup, “The history of referendums and direct democracy”. Në Laurence Morel and Matt Qvortrup (eds.), The Routledge Handbook to Referendums and Direct Democracy (Routledge: New York, 2018)
- Matthew C. R. Craven, “The European Community Arbitration Commission on Yugoslavia” *British Yearbook of International Law*, Volume 66, Issue 1 (1995)
- Maurizio Ragazzi, “CONFERENCE ON YUGOSLAVIA ARBITRATION COMMISSION: OPINIONS ON QUESTIONS ARISING FROM THE DISSOLUTION OF YUGOSLAVIA” International Legal Materials Vol. 31, No. 6 (NOVEMBER 1992)
- Mauro Calise, Mauro (1994)”The Italian Particracy: Beyond President and Parliament”. Political Science Quarterly. Vol. 109 No. 3 (1994)

- May Chehab, “Philhellenism and Constitutionalism: The First Greek Constitutions”. Në Martin Vöhler, Stella Alekou and Miltos Pechlivanos (eds.), Concepts and Functions of Philhellenism. Aspects of a Transcultural Movement (DE GRUYTER: Berlin/Boston, 2021)
- McGaw Smyth, Howard (September 1948)”.Italy: From Fascism to the Republic (1943-1946)”. The Western Political Quarterly Vol. 1 No. 3 (September 1948)
- Michael C. Wood, “Participation of Former Yugoslav States in teh United Nations and Multilateral Treaties”. Max Planck Yearbook of United Nations Law Vol. 1 (1997)
- Michael J. Glennon, “Can the President Do No Wrong?” The American Journal of International Law, Vol. 80 No. 4 (October 1986)
- Michael Laver, “Governmental Politics and the Dynamics of Multiparty Competition”. Political Research Quarterly. Vol. 61 No. 3 (September 2008)
- Michael Riegner, “The Two Faces of the Internationalized pouvoir constituant: Independence and Constitution-Making Under External Influence in Kosovo”. Goettingen Journal of International Law Vol. 2 No. 3 (2010)
- Michael S. Green, “Hans Kelsen and the Logic of Legal Systems” Alabama Law Review Vol. 54 No. 2003
- Michael V. Kryukov, “Self-determination from Marx to Mao” Ethnic and Racial Studies Vol. 19 Issue 2 (1996)
- Michaela Hailbronner and Stefan Martini, “The German Constitutional Court”. Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), Comparative Constitutional Reasoning
- Michel Rosenfeld and Andras Sajo, “Introduction”. Në Michel Rosenfeld and Andras Sajo(eds.), The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law (Oxford University Press: Oxford, 2012)
- Michel Rosenfeld, “Contract and Justice: The Relation Between Classical Contract Law and Social Contract Theory”. Iowa Law Review Vol 70 No. 4 (May 1985)
- Michel Rosenfeld, “Rethinking the boundaries Between public Law and private Law for the twenty first century: An introduction” International Journal of Constitutional Law Vol. 11 No. 1(February, (2013)
- Mijat Šuković, “Tri različita ustavna uređenja Crne Gore”, Revus. Journal for Constitutional Theory and Philosophy of Law/Revija za ustavno teorijo in filozofijo prava. Vol. 11 (2009)
- Mirosal Cerar, “Slovenia’s Constitutional Court Within the Separation of Powers”. Në Wojciech Sadurski (ed.), Constitutional Justice, East and West: Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective (Kluwer Law International: The Hague, 2010)
- Mogens Herman Hansen, The Athenian Ecclesia: A Collection of Articles 1976-1983, Volume I (Museum Tusculanum Press: Copenhagen, 1983)
- Mogens Herman Hansen, The Athenian Ecclesia: A Collection of Articles 1983-1989, Volume II (Museum Tusculanum Press: Copenhagen, 1989)
- Morgan, “Selecting a Prime Minister” The Australian Quarterly. Vol. 36 No. 2 (June 1964)
- Nikola Fabris, Radokje Žugić, “*Regionalisation and regional policy of Montenegro*”. Journal of the Geographical Institute Jovan Cvijic (SASA) Vol. 62 No. 1 (2012)
- Nikos Marantzidis, “The Greek Civil War (1944–1949) and the International Communist System” Journal of Cold War Studies Vol. 15, No. 4 (Fall 2013)
- Norbert Foulquier, “Maurice Hauriou, constitutionnaliste (1856-1929)”. Jus Politicum. Revue internationale de droit politique No. 2 (2009)
- Octavio Amorim Neto & Kaare Strøm, “Breaking the Parliamentary Chain of Delegation: Presidents and Non-Partisan Cabinet Members in European Democracies” British Journal of Political Science. Vol. 36 No. 4 (2006)
- Oliver Duhamel, “France’s New Five - Year Presidential Term”. BROOKINGS, 1 March 2001
- Oliver Nikolić, “Referendum (sa posebnim osvrtom na Švajcarsku i Hrvatsku)” Strani pravni život God. 57 br. 1 (2013)

- Olivier Beaud, "Federation and empire: About a conceptual distinction of political forms". International Journal of Constitutional Law (2018), Vol. 16 No. 4 (2018)
- Olivier Jouanjan, "Historie de la science du droit constitutionnel". Në Michel Troper et Dominique Chagnollaud (eds.), Traite international de droit constitutionnel. Tome 1: Theorie de la Constitution (Dalloz: Paris, 2012)
- Padam Nepal, "Revisiting the Ideas of Hobbes, Locke and Rousseau in an Ecopolitical Context" The Indian Journal of Political Science Vol. 71 No. 3 (July – September 2010)
- Paolo Carroza, "Il diritto socialista". Në Paolo Carrozza - Alfonso Di Giovine - Giuseppe F. Ferrari (eds.), Diritto costituzionale comparato (GLF Editori Laterza: Roma-Bari, 2009)
- Pasquale Pasquino, "Constitution et pouvoir constituant: le double corps du peuple". Në Jean Salem, Vincent Denis and Pierre-Yves Quiviger (eds.) FIGURES DE SIEYÈS. PHILOSOPHIE (Éditions de la Sorbonne: Paris, 2008)
- Patricia A. Essoff, "Finland v. Denmark: A Call to Clarify the International Court of Justice's Standards for Provisional Measures" Fordham International Law Journal Vol. 15 Issue 3 (1991)
- Patrick Wachsmann, "Le Conseil constitutionnel et le principe de séparation des autorités administrative et judiciaire" JUS POLITICUM. Revue de droit politique No. 20-21 (Julliet 2018)
- Patrick Macklem, "Human rights in international law: three generations or one?" *London Review of International Law*, Volume 3, Issue 1 (March 2015)
- Patrick Macklem, "Militant democracy, legal pluralism, and the paradox of self-determination". International Journal of Constitutional Law Vol 4 No 3 (July 2006)
- Paul Sigmund, "Carl Friedrich's Contribution to the Theory of Constitutionalism – Comparative Government". Nomos Vol. 20, CONSTITUTIONALISM (1979)
- Peter Evan Bass, "Ex-Head of State Immunity: A Proposed Statutory Tool of Foreign Policy" The Yale Law Journal. Vol. 97 No. 2 (December 1987)
- Peter Mandler, Aristocratic Government in the Age of Reform Whigs and Liberals 1830-1852 (Clarendon Press: Oxford, 1990)
- Peter Radan, "The Badinter Arbitration Commission and the Partition of Yugoslavia" Nationalities Papers Vol. 25 No 3 (1997)
- Petersmann, Ernst-Ulrich, "Human Rights, International Economic Law and 'Constitutional Justice'". European Journal of International Law Vol. 19 No. 4 (2008)
- Philip Pettit, "Rousseau's dilemma". Në Avi Lifschitz (ed), Engaging with Rousseau: Reception and Interpretation from the Eighteenth Century to the Present (Cambridge University Press: Cambridge, 2016)
- Philipp C. Stiel".Nadzor države nad jedinicama lokalne samouprave u Bavarskoj - samouprava, demokracija i pravna država - simbioza ili proturječnost? Hrvatska Javna Uprava, god. 1 br. 2 (1999)
- Philipp Lottholz & Nicolas Lemay-Hébert, "Re-reading Weber, re-conceptualizing state building: from neo-Weberian to post-Weberian approaches to state, legitimacy and state-building". Cambridge Review of International Affairs, Vol. 29 No. 4 (2016)
- Philippe Lauvaux, "Le roi" Pouvoirs Vol. 136 No. 1 (2011)
- Pierre Brunet, "La representation". Në Michel Troper, Dominique Chagnollaud, Traité international de droit constitutionnel. Théorie de la Constitution. Tome 1 (Traités Dalloz: Paris, 2012)
- Professor Louis Aucoin, "Views from the Field On Constitution Writing: The Case of Kosovo (Interview)". PRAXIS: The Fletcher Journal of Human Security XXIII (2008)
- R. K. Alderman and J. A. Cross, "The Reluctant Knife: Reflections on the Prime Minister's Powers of Dismissal". Parliamentary Affairs. Vol. 38 No. 4 (Autumn, 1985)
- R. St. J. Maçdonald, "Interim Measures in International Law, with Special Reference to the European System for the Protection of Human Rights" Max-Planck-Institut für ausländisches öffentliches Recht und Völkerrech (1992)
- R. W. Seton-Watson, "The Yugoslav Constitutional Position" The Slavonic and East European Review Vol. 23 No. 62 (January 1945)

- Reinin, Ewald, "From the Federalist Papers to Hans Kelsen's"Dearest Child": The Genesis of the Austrian Constitutional Court", Zeitschrift für öffentliches Recht/Journal of Public Law Vol. 76 Issue 2 (June 2021)
- Rett R. Ludwikowski, "Constitutional Culture of the New East-Central European Democracies". Georgia Journal of International & Comparative Law. Vol. 29 No 1 (2000)
- Reut Yael Paz, "Kelsen's Pure Theory of Law as 'a Hole in Time'". Monde (s) Vol. 1 No. 2015
- Richard Albert and Joel Colón-Ríos (eds.), Quasi-Constitutionality and Constitutional Statutes. Forms, Functions, Applications (Routledge: United Kingdom, 2020)
- Richard Albert, "Quasi-Constitutional Amendments" Bufalo Law Review Vol. 65 No. 4 (2017)
- Richard C. Feiock, Moon-Gi Jeong and Jaehoon Kim, "Credible Commitment and Council-Manager Government: Implications for Policy Instrument Choices" Public Administration Review Vol. 63 No. 5 (Sep. - Oct., 2003)
- Richard G. Mulgan, "Lot as a Democratic Device of Selection". The Review of Politics Vol. 46, No. 4 (October 1984)
- Rick Fawn, "Regions" and their study: wherefrom, what for and whereto? Review of International Studies Vol. 35, Globalising the Regional, Regionalising the Global (February 2009)
- Robert C. Angel, "Prime Ministerial Leadership in Japan: Recent Changes in Personal Style and Administrative Organization". Pacific Affairs. Vol. 61 No. 4 (Winter 1988-1989)
- Robert G. Moser, "Electoral Systems and the Number of Parties in Postcommunist States". World Politics Vol. 51 No. 3 (Apr., 1999)
- Robert H. Evans and Felice Rizzi, "Local Autonomies, Regional Governments and Metropolitan Areas in Italy" The Review of Politics Vol. 40, No. 1 (January 1978)
- Robert M. Hayden, "Constitutional Nationalism in the Formerly Yugoslav Republi" Slavic Review Vol. 51 No. 4 (Winter, 1992)
- Robert S. Summers, "The Place of Form in the Fundamentals of Law" (2001). Ratio Juris Vol. 14 No. 1 (March 2001)
- Roderick A. Maçdonald and Hoi Kong, "Judicial Independence as a Constitutional Virtue". Në Michel Rosenfeld and András Sajó (eds.), The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law (Oxford University Press: Oxford, 2012)
- Ronald L. Watts, "Federalism, Federal Political Systems, and Federations" Annual Review of Political Science Vol. 1 (1998)
- Rosanne van Alebeek, "Immunity and Human Rights? A Bifurcated Approach". Proceedings of the Annual Meeting (American Society of International Law Vol. 104 (March 24-27, 2010)
- Samet Dalipi and Krenar Shala, The Role of Decentralization on Security Improvement and Peace – Building in Kosovo (Friedrich Ebert Stiftung: Prishtina, October 2016)
- Sandrine Baume, "De l' usage des pouvoirs neutres". *Revue Français d'Histoire des Idées Politiques* Vol. No. 143 (2012)
- Sara Lagi, "Hans Kelsen and the Austrian Constitutional Court (1918-1929)" Revista Co-herencia Vol. 9 No 16 (Enero - Junio 2012)
- Seth M. Scheiner, "Commission Government in the Progressive Era: The New Brunswick, New Jersey, Example" Journal of Urban History Vol. 12 No. 2 (1986)
- Sidney B. Fay, "The Beginnings of the Standing Army in Prussia" The American Historical Review Vol. 22 No 4 (July 1917)
- Slim Laghmani, "Droit constitutionnel et Science politique Essentiellement a partir du cas français". Në Michel Troper Dominique Chagnollaud (eds.), Traité international de droit constitutionnel- Tome 1 (Traités Dalloz: Paris, 2012)
- Slobodan Jovanovic, Ustavno pravo Kraljevine srba, hrvata i slovenaca (Sluzbeni list SRJ: Beograd, 1995)
- Slobodan Samardzic (ed.), Norma i Odluka. Karl Smit i njegovi kriticari (Filip Visnjic: Beograd, 2001)
- Sona Golder Nadenichek Sona, "Pre-Electoral Coalition Formation in Parliamentary Democra-

cies" British Journal of Political Science. Vol. 36 No. 2 (April 2006)
- Sona Nadenichek Golder, "Pre-Electoral Coalition Formation in Parliamentary Democracies" British Journal of Political Science. Vol. 36 No. 2 (April 2006)
- Spasimir Domaradzki & Margaryta Khvostova & David Pupovac, "Karel Vasak's Generations of Rights and the Contemporary Human Rights Discourse". Human Rights Review (2019) Vol. 20 No. 4 (2019)
- Stanley G. Payne, "Nationalism, Regionalism and Micronationalism in Spain Journal of Contemporary History" Vol. 26 No. 3/4 (September, 1991)
- Stefan Talmon, "Who is a legitimate government in exile? Towards normative criteria for governmental legitimacy in international Law". Në Guy Goodwin-Gill and Stefan Talmon (eds.), The Reality of International Law. Essays in Honour of Ian Brownlie (Oxford University Press: Oxford, 1999)
- Stephan G. Hinghofer-Szalkay, "The Austrian Constitutional Court: Kelsen's Creation and Federalism's Contribution?" Fédéralisme 2034-6298 Volume 17: 2017 Les juridictions constitutionnelles suprêmes dans les États fédéraux: créatures et créateurs de fédéralisme, 1671
- Stephan Kirste, "*The Formal and Substantive Core of Human Rights"*. Humanities and Rights Global Network Journal Vol. 1 No. 1 (2019)
- Stephanos Stavros, "The Legal Status of Minorities in Greece Today: The Adequacy of their Protection in the Light of Current Human Rights Perceptions". Journal of Modern Greek Studies Vol. 13, No. 1 (May 1995)
- Steven D. Roper, "Are All Semipresidential Regimes the Same? A Comparison of Premier-Presidential Regimes: Comparative Politics Vol. 34 No. 3 (April 2002)
- Steven G. Calabresi and Joan L. Larsen, One Person One Office: Separation of Powers or Separation of Personnel" Cornell Law Review. Vol. 79 Issue 5 (July 1994)
- Steven Hill & Paul Linden-Retek, "Supervised Independence and Post-Conflict Sovereignty: The Dynamics of Hibridity in Kosovo's New Constitutional Court". The Yale Journal of International Law Online Vol. 36 (Fall 2010)
- Susan Rose-Ackerman, "The Regulatory State". Në Michel Rosenfeld and András Sajó (eds.), The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law
- Susana de la Sierra, "Provisional Court Protection in Administrative Disputes in Europe: The Constitutional Status of Interim Measures Deriving from the Right to Effective Court Protection. A Comparative Approach" European Law Journal Vol. 10 No. 1 (January 2004)
- Suzie Navot, "The Israeli Supreme Court". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), Comparative Constitutional Reasoning
- Shahar Hamieri, "Theorising regions through changes in statehood: rethinking the theory and method of comparative regionalism" Review of International Studies Vol. 39 Issue 2 (April 2013)
- Sharda Rath, "Federalism: A Conceptual Analysis". The Indian Journal of Political Science Vol. 39 No. 4 (Oct-Dec. 1978)
- Takanori Adachi, and Yasutora Watanabe, "Ministerial Weights and Government Formation: Estimation Using a Bargaining Model" Journal of Law, Economics, & Organization. Vol. 24 No. 1 (May 2008)
- Tamara Ehs, "Felix Frankfurter, Hans Kelsen, and the Practice of Judicial Review" Zeitschrift für ausländisches öfentliches Recht und Völkerrecht, ZAORV = Heidelberg Journal of International Law, HJIL, Vol. 73 No. 3 (2013)
- Tamas Gyorfi, "The Supreme Court (House of Lords) of the United Kingdom". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), Comparative Constitutional Reasoning
- Tania Groppi and Irene Spingo, "The Constitutional Court of Italy". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), Comparative Constitutional Reasoning
- Tanja Karakamiševa, "Human Rights in the Republic of Macedonia Seen Through the Lens of the Constitution and the Practice of Democracy". Revus. Journal for Constitutional Theory and Philosophy of Law/Revija za ustavno teorijo in filozofijo prava. Vol. 11 (2009)

- Tilman Hoppe, "Public Corruption: Limiting Criminal Immunity of Legislative, Executive and Judicial Officials in Europe" Vienna Journal of International Constitutional Law Vol. 5 No. 4 (2001)
- Timothy Baycroft, "National Diversity, Regionalism and Decentralism in France". Në Joost Augusteijn, Eric Storm (eds), Region and State in Nineteenth-Century Europe (Palgrave Macmillan, London, 2012)
- Tjaša Ivanc, Lokalna samouprava u Makedoniji. Lex Localis – Journal of Local Self-Government Vol. 5 No. 2 (Summer 2007)
- Tove H. Malloy, "Territorial or non-territorial autonomy: The tools for governing diversity". Në Brian C. H. Fong and Atsuko Ichijo, The Routledge Handbook of Comprative Territorial Autonomies
- Theresa A. Niedziela, "Franklin D. Roosevelt and the Supreme Court". Presidential Studies Quarterly Vol. 6 No. 4 (Fall, 1976)
- Thomas A. Baylis, "Presidents versus Prime Ministers: Shaping Executive Authority in Eastern Europe". World Politics. Vol. 48 No. 3 (April 1996)
- Thomas Burgenthal, "Modern Constitutions and Human Rights Treaties". Columbia Journal of Transnational Law Vol. 36 (Special Double Issue) 1997
- Thomas H. Johnson, Robert O. Slater and Pat McGowan, "Explaining African Military Coups d'Etat, 1960-1982" American Political Science Review Vol. 78 No. 3 (1983)
- Thomas J. Pressly, "Bullets and Ballots: Lincoln and the 'Right of Revolution'" The American Historical Review Vol. 67, No. 3 (April 1962)
- Thomas Morray, "Socio-Economic Rights and the Making of the 1937 Irish Constitution" Irish Political Studies Vol. 31 Issue 4 (2016)
- Thomas Mulligan, "Plural Voting for the Twenty-First Century". The Philosophical Quarterly Vol. 68 Issue 271 (April 2018)
- Vanessa Maçdonnell, "A Theory of Quasi-Constitutional Legislation" Osgoode Hall Law Journal Vol. 59 No. 1 (Winter 2016)
- Véronique Champeil-Desplats, "Hans Kelsen's Works and the Modern Theories of Human Rights". Në Peter Langford, Ian Bryan, John McGarry (eds.), Kelsenian Legal Science and the Nature of Law (Springer: Cham, 2017)
- Víctor Bretón, Miguel González, Blanca Rubio, Leandro Vergara-Camus, "Peasant and indigenous autonomy before and after the pink tide in Latin America" Journal of Agrarian Change (Special Issue) Vol. 22 Issue 3 (July 2022)
- Visar Morina, "The Newly Established Constitutional Court in Post-Status Kosovo: Selected Institutional and Procedural Concerns". Review of Central and East European Law Vol. 35 Issue 2 (2010)
- Vittoria Calabro, "1812–15: The debate about the High Court of the Siçilian Parliament". Parlaments, Estates and Representation Vol. 33 Issue 1 (2013)
- Vladimir Mikić, "Funkcije preambula savremenih ustava". PRAVNI ZAPISI God. V br. 2 (2014)
- Wen – Chen Chang, "The Constitutional Court of Taiwan". Në András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), Comparative Constitutional Reasoning
- Wendell R. Mauter, "Churchill and the Unification of Europe" The Historian Vol. 61 No. 1 (Fall 1998)
- William A. Glaser, "The Family and Voting Turnout". The Public Opinion Quarterly Vol. 23 No. 4 (Winter, 1959-1960)
- William A. Sommers, "Council-Manager Government: a Review". Western Political Quarterly Vol. 11 No.1 (1958)
- William H. Harbold, "Book Reviews: Précis de Droit Constitutionnel. By MAURICE HAURIOU". (Paris: Centre National de la Recherche Scientifique, Ministère de l'Education Nationale, 1965. Pp. xv, 759. 25F.)
- William I. Burstein and Ryan D. King, "Anti-Semitism in Europe Before the Holocaust" Interna-

tional Political Science Review Vol 25 No. 1 (2004)
- William J.H. Hough, III, "The Annexation of the Baltic States and Its Effect on the Development of Law Prohibiting Forcible Seizure of Territory", NYLS Journal of International and Comparative Law Vol. 6 No. 2 (1985)
- William Miller, "The Republic of San Marino". The American Historical Review, Vol. 6 No. 4 (July 1901)
- William O. Scroggs, "Commission Government in the South". The ANNALS of the American Academy of Political and Social Science Vol. 38 No. 3 (1911)
- William Rasch, "Human Rights as Geopolitics: Carl Schmitt and the Legal Form of American Supremacy" Cultural Critique No. 54 (Spring, 2003)
- Woodrow Wilson, "Leaderless Government" The Virginia Law Register Vol. 3 No 5 (September 1897)
- Yaniv Roznai, "Unconstitutional Constitutional Amendments-The Migration and Success of a Constitutional Idea" 61(3) American Journal of Comparative Law Vol. 61 No. 3 (2013)
- Yaniv Roznai, Unconstitutional Constitutional Amendments: A Study of the Nature and Limits of Constitutional Amendment Powers. A thesis submitted to the Department of Law of the London School of Economics for the degree of Doctor of Philosophy (The London School of Economics and Political Science: London, February 2014)
- Yves Haeck, Clara Burbano Herrera and Leo Zwaak, Strasbourg's Interim Measures Under Fire: Does the Rising Number of State Incompliances with Interim Measures Pose a Threat to the European Court of Human Rights? European Yearbook on Human Rights Vol. 11 (March 1, 2011)
- Zdeněk Kühn*, "The Constitutional Court of the Czech Repoublic". Në* András Jakab, Arthur Dyevre, Giulio Itzcovich (eds.), Comparative Constitutional Reasoning (Cambridge University Press: Cambridge, 2017)
- Zdenk Kühn and Jan Kysela, "Nomination of Constitutional Justices in Post-Communist Countries: Trial, Error, Conflict in the Czech Republic". European Constitutional Law Review Volume 2 Issue 02 (June 2006)
- Zeljko Fajfric, "Lokalna samouprava u ustavnom sistemu Jugosllavije i Srbije". Glasnik Advokatske Komore Vojvodine God. LXXI Br. 11 (Septembar 1999)
- Zoran Oklopcic, "The Paradox of Constitutionalism: Constituent Power and Constitutional Form". International Journal of Constitutional Law, Volume 6, Issue 2 (April 2008)

C. Akte Juridike:

- Aktgjykim në rastin KO 01/09. Qemajl Kurtishi dhe Kuvendi Komunal i Prizrenit. Prishtinë, datë: 18 mars 2010. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Ref. Nr. AGJ 07/10
- Aktgjykim në Rastin nr. 104/12. Parashtruesi: Esat Kelmendi. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 647/2011, të 30 nëntorit 2011. Datë: 20 korrik 2012 (Nr. Ref.: AGJ 285/12)
- Aktgjykim në Rastin Nr. I50/12. Parashtruesi: Agush Llolluni. Vlerësim i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 153/2011, të 4 tetorit 2011, dhe Vendimit Nr. 02 (207) 2010, të 4 tetorit 2010, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës nga Komuna e Junikut. Datë: 16 korrik 2012 (Nr. ref.: AGJ/279/12)
- Aktgjykim në Rastin Nr. KI 108/10. Parashtruesi: Fadil Selmanaj. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ac. nr. 170/2009, të 25 shtatorit 2009. Datë: 5 dhjetor 2011. Nr. Ref.: AGJ. 163/11)
- Aktgjykim në Rastin Nr. KI 129/11. Parashtruesi: Viktor Marku. Vlerësim i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. Dr. 158/2011 të 5 korrikut 2011 dhe vendimit nr. 02/197/2010 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës nga ana e Komunës së Klinës. Datë: 17 korrik 2012 (Nr. ref.: AGJ/282/12)
- Aktgjykim në Rastin Nr. KI 55/11. Parashtruesi: Fatmir Pireci. Vlerësim i kushtetutshmërisë të

Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 518/2010, të 26 nëntorit 2010. Datë: 16 korrik 2012 (Nr. ref.: RK/277/12)

- Aktgjykim në Rastin Nr. KI 47/12. Parashtruesi: Islam Thaçi. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme Rev. Nr. 188/2009, të 7 dhjetorit 2011. Datë: 16 korrik 2012 (Nr.ref.: AGJ 278/12)
- Aktgjykim në rastin nr. KO 26/15. Vleresim i amendamentit të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe referuar më 9 mars 2015 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, me shkresën nr. 05-433 /DO-318. Prishtinë, më 15 prill 2015. Nr. ref.: AGJ 788/15
- Aktgjykim në rastin nr. KO 72/20. Parashtrues: Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës Vlerësim i kushtetutshmërisë së Dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. 24/2020, të datës 30 prill 2020
- Aktgjykim. Rasti Nr. KI 56/09. Parashtruesit: Fadil Hoxha dhe 59 te tjerë kundër Kuvendit Komunal te Prizrenit. Prishtinë, datë: 18 mars 2010. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Ref. Nr. AGJ 07/10
- Aktgjykim. Rasti nr. KO 130/15. Parashtrues: Presidentja e Republikës së Kosovës lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar ”Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe ne Kosovë -Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore” me frymën e Kushtetutës, me nenio 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Prishtinë, 23 dhjetor 2015. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Ref.: Nr. AGJ 877/15
- Aktgjykim: Rasti nr. KI 47/10, “Naim Rrustemi dhe 31 deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kundër Shkëlqesisë së tij, Fatmir Sejdiu, President i Republikës së Kosovës”
- Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese të Belgjikës nr. 35/94 i datës 10 maj 1994
- Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë, No. 1 BvR 1595/92 1BvR 1606/92, i datës 14 korrik 1994
- Aktgjykim në Rastet KO. 29/12 dhe KO. 48/12. Amendamentet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars dhe 4 maj 2012. Datë 20 korrik 2012. Prishtinë. Nr. ref.: AGJ 284/12
- Aktgjykim në Rasti KI 11/09. Vendim. Masë e Përkohshme / MP /. Tomë Krasniqi vs. RTK (“Radio Televizioni Kosovës”) dhe KEK (“Korporata Energjetike e Kosovës”). Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, më 16 tetor 2009
- Aktgjykimi në Rasti KI 150/16. Aktgjykim. Parashtrues: Mark Frrok Gjokaj Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës
- Aktgjykim në Rasti KI 48/18. Aktgjykim. Parashtrues: Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit AA. nr. 52/2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të 25 nëntorit 2017 dhe Aktgjykimit A.A. U. ZH. nr. 62/2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të 7 dhjetorit 2017
- Aktgjykim në Rasti KK 124/14. Aktvendim. Hetimi për pretendimet e sjelljes jokushtetuese nga gjyqtari Kadri Kryeziu
- Aktgjykim në Rasti KO 38/12. Aktgjykim. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Propozimeve të Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës, të dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës më 12 prill 2012
- Aktgjykim në Rasti KO 79/18. Aktvendim për Papranueshmëri. Parashtrues: Presidenti i Republikës së Kosovës. Kërkesë për interpretim të nenit 139 paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Nr. rcf.: RK 1294/ 18. Prishtinë, 3 dhjetor 2018
- Aktgjykim në Rasti KO 80/10. Aktgjykim. Kërkesa e Presidentit të Republikës se Kosovës, Shkelqesise se tiL Dr. Fatmir Sejdiu, per sqarim te kompetencave ne rastin e kryetarit te Rahovecit, z. Qazim Qeska. Ref. nr. AGJ 46110. Prishtine, me 7 Tetor 2010
- Aktgjykim në Rasti KO 98/11. Parashtrues Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me imunitetin

e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës
- Aktgjykim në Rastin K.O. 29/11"Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë". Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04- V-04, të 22 shkurtit 2011, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës
- Aktgjykimi në rastin KO 97/10
- Amendamentet I – XXII. Amendamentimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare te pavarësisë së Kosovës (*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës* nr. 25 datë 7 shtator 2012
- Amendamentet XVIII-LV në Kushtetutën e KSAK. Gazeta Zyrtare e KSAK nr. 24. Prishtinë, 1989
- AMENDAMENTIMI I KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, NR. 05 - V – 139 I DATËS 3 GUSHT 2013. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr.20/05 gusht 2015, PRISHTINË
- Belgrade-Pristina Dialogue: EU Proposal - Agreement on the path to normalisation between Kosovo and Serbia (27 shkurt 2023) dhe Belgrade-Pristina Dialogue: Implementation Annex to the Agreement on the Path to Normalisation of Relations between Kosovo and Serbia (18 mars 2023). Burimi: EEAS PRESS TEAM (2023)
- Basic Law for the Federal Republic of Germany. 1949
- Bosnia and Herzegovina's Constitution of 1995
- Burkina Faso's Constitution of 1991 with Amendments through 2012
- Cameroon's Constitution of 1972
- Chad's Constitution of 1996
- Constitution of Ireland 1937
- Constitution of the Principality of Liechtenstein of 5 October 1921. As of: 1 February 2014
- Constitution of the Syrian Arab Republic, 2012
- Constitution of Weimar 1919
- Costa Rica's Constitution of 1949 with Amendments through 2011
- Déclaration des droits de l'homme et du citoyen de 1793. Në internet: https://www.lexilogos.com/ declaration/droits_homme_1793.htm
- Déclaration des droits de la femme et de la citoyenne, 1791. Në internet: https://gallica.bnf.Fr/essentiels /anthologie/declaration-droits-femme-citoyenne-0
- Declaration of Rights of the Working and Exploited People. 3 January, 1918. Në internet: https://www.marxists.org/archive/lenin/works/1918/jan/03.htm
- Deklarata e Kombeve të Bashkuara, 1942
- Deklarata e Moskës, 1943 dhe Tehranit, 1943
- Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, 2008
- DEKRET PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE. NR. DMN - 003 – 2016. Prishtinë 3 shkurt 2016
- Denmark's Constitution of 1953
- Final agreement for the settlement of the differences as described in United Nations Security Council resolutions 817 (1993) and 845 (1993), the termination of the Interim Accord of 1995, and the establishment of a strategic partnership between the Parties
- Fourth Protocol to the General Agreement on Privileges and Immunities of the Council of Europe. Paris, 16. XII. 1961
- Framework Agreement (Ohrid Agreement) 13.08.2001
- Gjykata Kushtetuese e Moldavisë në vendimin 1/2008
- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Afrikës së Jugut në vendimin, Nr. CCT 42/09
- Gjykata Supreme e Kosovës. Aktgjykim. AA.nr.30/2021. Datë 11 mars 2021 (Prishtinë)
- Hungary's Constitution of 2011
- Interim Agreement between the Kingdom of the Netherlands and the Republic of Kosovo con-

cerning the Hosting of the Kosovo Relocated Specialist Judicial Institution in the Netherlands. Pristina, 26 January 2016
- International Court of Justice, International Accordance with International Law of The Unilateral Declaration of Independence In Respect of Kosovo, Advisory Opinion of 22 July 2010
- Karta e Kombeve të Bashkuara, 1945
- Kodi nr. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr. 2/14 janar 2019, Prishtinë
- Kodi nr. 08/L-032 i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr. 24/17 gusht 2022, Prishtinë
- Kodi Zgjedhor (draft tekst i konsoliduar), version jozyrtar i përgatitur nga Zyra e Ekspertëve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, (Gazeta Zyrtare, nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16 136/16, 142/16, 67/17, 125/17, 35/18, 99/18, 140/18, 208/18, 27/19, 98/19 и 42/20)
- KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (miratuar me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 dhe ndryshuar me ligjet nr.74/2012, datë 19.07.2012, nr. 31/2015, datë 02.04.2015, nr. 101/2020, datë 23.7.2020, dhe nr. 118/2020, datë 5.10.2020)
- Kornizë Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, 2001
- Kushtetuta e Kaçanikut, 1990
- Kushtetuta e Koresë së Jugut, 1948
- Kushtetuta e KSA të Kosovës. Gazeta Zyrtare e KSAK nr. 4. Prishtinë, 1974
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1998
- Kushtetuta e Austrisë, 1920
- Kushtetuta e Bullgarisë, 1991
- Kushtetuta e Indisë (1949)
- Kushtetuta e Spanjës, 1978
- Laussanne Peace Treaty VI. Convention Concerning the Exchange of Greek and Turkish Populations Signed at Lausanne, January 30, 1912
- LIGJ Nr. 8577, datë 10.2.2000 PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
- Ligja Kushtetuese e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, botuar në THGB Fletorja Zyrtare e KSAK. Prishtinë (1969)
- Ligji nr 7491, datë 29.4.1991 për dispozitat kryesore kushtetuese
- Ligji nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: VITI III/Nr. 28/4 qershor 2008
- Ligji nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë: VITI III/Nr. 31/15 qershor 2008
- Ligji nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr. 45/ 15 janar 2009, Prishtinë
- Ligji nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr. 87/16 nëntor 2010, Prishtinë.
- LIGJI NR. 04/L -274 PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE NË MES TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE BASHKIMIT EVROPIAN MBI MISIONIN E BASHKIMIT EVROPIAN PËR SUNDIM TË LIGJIT NË KOSOVË. Gazeta Zyrtare e Republkikës së Kosovës nr. 32/14. Datë 15 maj 2014
- Ligji nr. 04/L-003 për gjendjen civile. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr. 6/22 korrik 2011, Prishtinë
- Ligji nr. 04/L-025 për nisma legjislative. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 23/26 tetor 2011, Prishtinë
- LIGJI NR. 04/L-199 PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË PARË NDËRKOMBËTARE

TË PARIMEVE QË RREGULLOJNË NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE MES REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE REPUBLIKËS SË SERBISË
- Ligji Nr. 04/L-199 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë Ndërkombëtare të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 38/17 shtator 2011/Prishtinë
- Ligji nr. 04/L-215 për shtetësinë e Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr. 33/2 shtator 2013, Prishtinë
- Ligji Nr. 05/L-053 PËR DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRËN E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR. Prishtinë 3 gusht 2015
- Ligji nr. 05/L-087 për kundërvajtje. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr. 33/3 shtator 2016, Prishtinë
- LIGJI Nr. 06/L-122 PËR MINISTRINË E MBROJTJES
- LIGJI Nr. 06/L-123 PËR FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS
- LIGJI Nr. 06/L-124 PËR SHËRBIM NË FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS
- Ligji nr. 107/2016, dt. 27.10.2016 ”PËR PREFEKTIN E QARKUT”. Fletore Zyrtare 217 (2016)
- Ligji nr. 8652, dt. 31.07.2000, “Për organizimin dhe funskionimin e Qeverisjes Vendore”. Fletore Zyrtare nr. 25 (2000). Aktualisht në fuqi është Ligji nr. 139/2015 për vetëqverisjen vendore, miratuar më datën 17.12.2015. Fletore Zyrtare nr. 249 (2015)
- Ligji nr. Nr. 05/L -031 për procedurën e përgjithshme administrative. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr. 20/21 qershor 2015, Prishtinë
- Ligji Nr.08/L-036 për dërgimin e FSK jashtë vendit
- *Ligjit nr. 04/L-215 për shtetësinë e Kosovës.* Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 33, 2 shtator 2013, Prishtinë
- Implementation Annex to the Agreement on the Path to Normalisation of Relations between Kosovo and Serbia (18 mars 2023). Burimi: EEAS PRESS TEAM (2023)
- Marrëveshja e Rambujesë, 1999
- PCIJ (Permanent Court Of International Justice) Pcij Series B. No 17 Greco-Bulgarian ”Communities”. Advisory Opinion 31 July 1930
- Portugal’s Constitution of 1976 with Amendments through 2005
- Portugal’s Constitution of 1976
- Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës, 2 shkurt 2007
- Rambouillet Accords: Interim Agreement for Peace and Self-Government in Kosovo. Letter dated 4 June 1999 from the Permanent Representative of \france to the United Nations Adressed to the Secretary General. Security Council S/1999/648. 7June 1999. English. Original: French
- Regulation No.1999/1.Unmik/Reg/1999/1.25 July 1999 On The Authority Of The Interim Administration In Kosovo
- *República Federativa de Brasil/ Federative Republic of Brazil. Constitución Política de 1934*
- Resolution 1244 (1999), Adopted by the Security Council at its 4011th meeting, on 10 June 1999. Security Council. S/RES/1244 (1999) 10 June 1999
- Resolution adopted by the General Assembly. A/RES/64/298
- Romania’s Constitution of 1991
- Russian Federation’s Constitution of 1993
- Rregullore e UNMIK-ut nr. 2001/9 për Kornizën kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme, datë 15 maj 2001
- Rregullore e UNMIK-ut nr. 2003/11. Ndryshimi Rregullores nr.1999/14 për emërimin e administratorëve rajonalë dhe komunalë, datë 22 maj 2001
- Rregullore UNMIK-ut nr. 2000/43, datë 27 korrik 2000, mbi numrin, emrat dhe kufijtë e komunave
- Rregullore UNMIK-ut nr. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, datë 11 gusht 2000
- Rregullore UNMIK-ut nr.1999/14 për emërimin e administratorëve rajonalë dhe komunalë, datë

21 tetor 1999
- Rregullorja Nr. 24/1999 mbi Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë e datës 12 dhjetor 1999
- Sqarim i Aktgjykimit në rastin KO 29/11"Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë". Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04- V-04, të 22 shkurtit 2011, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, "Sqarimet e kërkuara për Vendimin e shumicës, të 30 marsit 2011", datë: me 1 prill 2011, Nr. ref.: SQ 111/11
- Statute of the Siçilian Regional Government (Siçily Region: Presidency)
- Statutin e Lushnjës, 1920
- Statutin Themeltar të Republikës Shqiptare (u botua në "Fletoren Zyrtare" më 7 mars 1925)
- Sweden's Constitution of 1974 with Amendments through 2012
- Togo's Constitution of 1992
- Turkey's Constitution of 1982 with Amendments through 2017
- The Constitution of India, 2020
- The General Framework Agreement for Peace in Bosnia and Herzegovina. Initialled in Dayton on 21 November 1995 and signed in Paris on 14 December 1995
- The Greek Declaration of Independence 1822
- The London Protocol of 3 February 1830
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut U.br. 140/99, i datës 14.6.2000
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Bjellorusisë, Nr. J-18/95 i datës 27.10.1995
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë 01/10 i datës 31 mars 2010
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë 16/95 i datës 19 shtator 1995
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë, Nr. 12/96, i datës 23 korrik 1996
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Federatës Ruse, i dates 1 dhjetor 1999
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë Nr. 29/2011 i datës 7.4.2011
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë U-II- 1095/1995, U-II-1021/1995
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë, Nr. U-VII-700/1997 i datës 11 qershor 1997
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë 70/06 i datës 23.05.2007.
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë Nr. 19/97 i datës 10.1.1998
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë, 3/95 i datës 06.12.1995
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë, Nr. 24/04, datë 25.5.2004
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë, Nr. 7/08, i dates 07 korrik 2010
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Moldavisë nr. 21 i datës 2 shtator 2004
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Portugalisë, Nr. 976/96 i datës 27 korrik 1996
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Afrikës së Jugut, Nr. CCT 27/95 i dates 22.09.1995
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Afrikës së Jugut, Nr. CCT 54/09, i datës 23 shkurt 2010
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë PL. US 1/86 I datës 14.11.1996
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë PL.US 7/96 i datës 27 shkurt 1997
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë, Nr. II.US 31/97, datë 21 maj 997
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë, Nr. II.US 65/97 i datës 10 dhjetor 1997
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë, Nr. PL. US 8/97, i datës 24 qershor 1998
- Vendim i Gjykatës Supreme të Estonisë 3-4-1-5-2000, i datës 15 maj 2000
- Vendim i Gjykatës Supreme të Meksikos, Nr. 198 i datës 28.5.2003
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë Nr. 4/94 i datës 21.6.1994)
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë nr. 8/2011 i datës 18.2.2011
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Federale të Gjermanisë nr. 1BvR 1693/92 i datës 8 shkurt 1994)
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Afrikës së Jugut, Nr. CCT 53/11, 54/11, 62/11, i datës 29.07.2011
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Ukrainës, Nr. 3-rp/2008, i dates 01.04.2008

- Vendim i Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04- V- 436 të datës 7 shtator 2012
- Vendim i Tribunalit Kushtetues të Polonisë K-37/05, datë 25 tetor 2005

D. Materiale të tjera:

- BROSHURË INFORMATIVE MBI PROCESET ZGJEDHORE PARLAMENTARE DHE LOKALE NË SHQIPËRI, MBI PARTITË POLITIKE, LEGJISLACIONIN, REKOMANDIMET E OSBE/ODIHR (1991-2020). Me ilustrime krahasuese nga Holanda, Kroacia, Sllovenia dhe Estonia (Tiranë: 2020). Në internet: www.isp.com.al
- CEMI, IZBORNI I PARTIJSKI SISTEM U CRNOJ GORI. PERSPEKTIVA RAZVOJA UNUTARPARTIJSKE DEMOKRATIJE (Centar za monitoring i istraživanje CeMI: Podgorica, 2007)
- CEMI, Reforma izbornog zakonodavstva u Crnoj Gori. Prijedlozi za unapređenje (Centar za monitoring i istraživanje CeMI: Podgorica, 2015)
- Centar za monitoring CEMI, Referendum u Crnoj Gori 2006. godine (Podgorica, 2006)
- CeSID, Oko izbora. Izvestaj sa lokalnih izbora za odbornike 19 skupstina opstina Crne Gore (15. maja 2002. godine) (CENTAR ZA SLOBODNE IZBORE I DEMOKRATIJU: Podgorica, 2002)
- CONSOLIDATED VERSIONS OF THE TREATY ON EUROPEAN UNION AND THE TREATY ON THE FUNCTIONING OF THE EUROPEAN UNION (2010/C 83/01). Official Journal of the European Union. Volume 53 (30 March 2010)
- Council of Europe, Federalism, Regionalism, Local Autonomy and Minorities: Proceedings, Cividale Del Friuli (Italy), 24-26 October 1996: Conference (CoE Publications: Strasbourg, 1 January 1997)
- Deklarata e Moskës, 1943 dhe Tehranit, 1943
- Electoral System Design Database Codebook (International IDEA, 2018). Në internet: https://www.idea.int/publications/esd/index.cfm
- Electoral Systems (ACEA: 2005). Në internet: https://aceproject.org/ace-en/topics/es/default
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Draft outline of main elements for an agreement on Kosovo*. CONFIDENTIAL (Council of Europe: Strasbourg, 31/08/98)
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), Models of Constitutional Jurisdiction (Council of Europe Press: Strasbourg, 994)
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), The Composition of Constitutional Courts, Judicial Appointments. Venice, 22 June 2007
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), Amicus Curiae Brief on the Immunity of Judges for the Constitutional Court of Moldova. Adopted by the Venice Commission at Its 94th Plenary Session (Venice, 8-9 March 2013)
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), Memorandum Reform of the Judicial System in Bulgaria. Conclusions adopted by the Venice Commission at its 55th plenary session (Venice, 13-14 June 2003)
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), Opinion on the Draft Law on Judges and Prosecutor of Turkey. Adopted by the Venice Commission at its 86th Plenary Session (Venice, 25-26 March 2011)
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), Opinion on Act CLI of 2011 on the Constitutional Court of Hungary. Adopted by the Venice Commission at its 91st Plenary Session (Venice, 15-16 June 2012)
- European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), Opinion on Proposals Amending the Drfat Law on the Amendments to the Constitution to Strengthen the Independence of Judges of Ukraine. Adopted by the Venice Commission at its 97th Plenary Session (Venice, 6-7 December 2013)
- European Commission for Democracy Through Law (Vennice Commission), "The Relationship

Between International and Domestic Law". Science and Technique of Democracy No. 5. CDL – STD (1995) 005 (Strasburg, 15 September 1993)
- Failure to Protect: Anti-Minority Violence in Kosovo, March 2004. *HUMAN RIGHTS WATCH* Vol. 16 No. 6 (July 2004)
- Final agreement for the settlement of the differences as described in United Nations Security Council resolutions 817 (1993) and 845 (1993), the termination of the Interim Accord of 1995, and the establishment of a strategic partnership between the Parties
- IFIMES, Parlamentarni izboru u Sjevernoj Makedoniji 2020: Članstvo u NATO-u historijski uspjeh (9/12/22). Në internet: https://www.ifimes. org/ba/ istrazivanja/parlamentarni-izboru-u-sjevernoj-makedoniji-2020-clanstvo-u-nato-uhistorijski-uspjehparlamentarni-izb ori-vo-severna-makedonija-2020-clenstvoto-vo-nato-kako-istoriski-uspex/4606
- Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS), Abetarja e pushtetit: Libërth mbi politikën, njerëzit dhe partitë në Kosovë (Prishtinë, dhjetor 2011). Ne internet: https://cupdf.com/document/abetarja-e-pushtetit-librth-mbi-politikn-njerzit-ishte-situata-politike.html?page=1
- Instituti Demokracia për zhvillim, Trendet zgjedhore 2000-2014. Analizë numerike e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit (Prishtinë, 2015). Në internet: https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2015/07/D4D_ ELECTIONS_ 9 _ Trendet_Zgjedhore_2000-2014_SHQ_-web.pdf (shikuar më 18 shtator 2022)
- International Conference on "The Influence of the ECHR Case-Law on National Constitutional Jurisprudence". Kyiv, Ukraine, 13-16.10.2005. Extracts from CODICES Database of the Venice Commission
- Izvješće o provedenom referendumu. Republička komisija za provedbu referenduma. 22. svibnja 1991
- Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian (KKGJE) Opinioni nr. 3 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian për dijeni të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në lidhje me parimet dhe rregullat që rregullojnë sjelljen profesionale të gjyqtarëve, e në veçanti me etikën, sjelljen e papajtueshme dhe paanshmerinë, Strasburg, 19 nëntor 2002)
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Manual i Komisionit të Zonës së Administrimit të Zgjedhjeve (Tiranë: 2015). Në internet: www.cec.org.al
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Trendet zgjedhore në Republikën e Kosovës. Më shumë së një dekadë në statistika zgjedhore (Prishtinë, 2022). Në internet: http://www.kqz-ks.org/
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Zgjedhjet në Kosovë 2000-2014 (KQZ: Prishtinë, 2017). Në internet: www.kqz-ks.org
- Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ), Vendim për moszbatimin e votimit në PDK - 2020. Në internet: https://drive.google.com/file/d/1 YL_Qqv Q03 bXPdyJ9BF9I1BtKë_2cN5Ac/view
- Laussanne Peace Treaty VI. Convention Concerning the Exchange of Greek and Turkish Populations Signed at Lausanne, January 30, 1912
- Letter dated 17 November 2004 from the Secretary-General addressed to the President of the Security Council. Report on the situation in Kosovo.*United Nations.*S/2004/932- Security Council Report. 30 November 2004
- Madison, *Federalist No. 49*, 5 February 1788 (New York)
- Manual për zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë 2017. Edicioni i dytë i përditësuar (Konrad Adenauer Stiftung dhe Instituti për Demokraci "Societas Civilis": Shkup, 2017)
- Manual për zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2020 (Konrad Adenauer Stiftung dhe Instituti për Demokraci "Societas Civilis": Shkup, 2020)
- Marija Risteska and Zhidas Daskalovski (eds.), *One Decade after the Ohrid Framework Agreement: Lessons (to be) Learned from the Macedonian Experience* (Friedrich Ebert Stiftung and Center for Research and Policy Making: Skopje 2011)
- *Memorandum Srpske Akademije Nauka i Umetnosti (nacrt) Jesen 1986*
- Mendimi konkurrues i gjyqtarit Almiro Rodrigues për aktgjykimin në rastin nr. 01/09
- Office of the Privacy Commissioner of Canada (ed.), Surveillance, Search or Seizure Powers

Extended by Recent Legislation in Canada, Britain, France and the United States
- Opinion No. 1., International Legal Materials, 31 (1992)
- Opinionin e Përbashkët të vitit 2020 të Komisionit të Venecias dhe ODIHR-it: Opinion No. 1006 / 2020 ODIHR Opinion Nr ELE-ALB/396/2020 CDL-AD(2020)036 Or. Engl. EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION) OSCE OFFICE FOR DEMOCRATIC INSTITUTIONS AND HUMAN RIGHTS (OSCE/ODIHR) ALBANIA JOINT OPINION ON THE AMENDMENTS TO THE CONSTITUTION OF 30 JULY 2020 AND TO THE ELECTORAL CODE OF 5 OCTOBER 202
- OSCE, MISIONI NDËRKOMBËTAR I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE. Republika e Shqipërisë – Zgjedhjet Parlamentare, 25 prill 2021. Deklaratë e Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake (Tiranë 2021).
- OSCE/ODIHR, Assessment of the Referendum Law. Republic of Montenegro. Federal Republic of Yugoslavia (Warsaw 6 July 2001)
- OSCE/ODIHR, Crna Gora. PARLAMENTARNI IZBORI: 30. AVGUST 2020. Ograničena posmatračka misija Kancelarije za demokratske institucije i ljudska prava (KDILJP). Konačni izvještaj (Varšava, 11. decembar 2020)
- Povelja drzavne zajednice Srbija i Crna Gora (4 februar 2003)
- Presidential Race 2012. Open Secrets. Në internet: https://www.opensecrets.org/pres12/ (shikuar më 4 shtator 2022) & ”2016 Presidential Race”. Open Secrets. Në internet: https://www.opensecrets. org/pres16
- Ram Subramanian, Léon Digard, Melvin Washington II and Stephanie Sorage, In the Shadows: A Review of the Research on Plea Bargaining (The Vera Institute of Justice: New York, 2020)
- Rambouillet Accords: Interim Agreement for Peace and Self-Government in Kosovo. *Letter dated 4 June 1999 from the Permanent Representative of \france to the United Nations Adressed to the Secretary General.* Security Council S/1999/648. 7June 1999. English. Original: French
- Raport me rekomandime i Avokatit të Popullit, rasti nr.683/2018, në lidhje me Ligjin 06/L-012 për Kryeqytetin e Republikes se Kosovës, perkatesish nenin 7 paragrafi 1, nen paragrafi 1.1 i cili rregullon sigurine publike si kompetence e kryeqytetit
- Report on Constitutional Amendment, adopted by the Venice Commission at its Plenary Session, Venice, 11-12 December 2009
- SISTEMI ZGJEDHOR I MAQEDONISË SË VERIUT–SI TË SIGUROHET PËRFAQËSIMI I DREJTË NË PARLAMENT (Instituti Nacional Demokratik: Shkup, 2022)
- Sporazum o principima odnosa Srbije i Crne Gore u okviru drzavne zajednice (14 mars 2002)
- Susan D. Hyde, “The U.S. election is over. What did international observers think?” The Washington Post November 9, 2020. at 6:16 a.m. EST
- Talleyrand Périgord Charles Maurice de, “Rapport par M. Talleyrand-Périgord, ancien évêque d’Autun, sur l’instruction publique, en annexe de la séance du 10 septembre 1791”. Në *Archives Parlementaires de 1787 à 1860- Première série (1787-1799)*. Tome XXX- Du 28 août au 17 septembre 1791. Paris: Librairie Administrative P. Dupont, 1888
- The First Gerrymander. Boston Gazette (Boston), 15 April 1813, Vol. 38 No. 33. Në internet: https://www.bonhams.com/auctions/21962/lot/120/
- The General Framework Agreement for Peace in Bosnia and Herzegovina. Initialled in Dayton on 21 November 1995 and signed in Paris on 14 December 1995
- Thomas Jefferson to James Madison, 6 September 1789 (Paris)
- Venice Commission, “Federal and Regjional States”. Science and Technique of Democracy No. 19 (CDL-STD 019: Strasbourg 1997)

Indexi:

A

Abati i Sijes 35
Abdylhamiti II 39
ab nihilo 96, 114, 119, 120, 121
aborti 240, 582
Abraham Linkoln 297, 385, 700
abrogimi 34, 96, 99, 121, 592, 728, 730, 748, 749, 818
absolute 40, 57, 65, 73, 94, 95, 103, 111, 126, 135, 149, 176, 187, 192, 193, 197, 202, 216, 223, 226, 234, 235, 239, 244, 247, 282, 287, 290, 300, 310, 317, 318, 350, 369, 371, 378, 400, 403, 405, 418, 426, 429, 430, 437, 441, 443, 444, 452, 463, 465, 468, 493, 503, 505, 513, 528, 567, 606, 609, 611, 614, 617, 638, 669, 674, 683, 699, 702, 709, 712, 742, 747, 749, 752, 795, 798, 815, 820, 825, 826
actio popularis 618
ad hoc 203, 422, 425, 445, 602, 771, 802
ad literam 182, 241
administrata 61, 70, 326, 340, 347, 354, 357, 401, 403, 406, 519, 545, 549, 554, 596, 641, 664, 684, 742, 746, 747, 755, 758, 766, 781, 810, 819, 821, 823
Administrata komunale 773, 823
administratë shtetërore 48, 519
administratori komunal 758, 760
administratori ndërkombëtar 760
administrimi lokal 742
Adolf Hitler 47, 219, 319
Adolf Tier 463, 484
afatet e shkurtra 323
Afrika e Jugut 65, 323, 419, 726
Afrikë 38, 351, 639
Agjencia e Kosovës për Inteligjencë 646
agjenci e institucione të pavarura 654
agjencitë dhe institucionet administrative 659
agjencitë dhe institucionet e specializuara 658
agjencive dhe institucioneve 144, 408, 653, 654, 655, 658, 659, 660, 675, 676
agregacion 698, 701, 708, 825
agresioni të armatosur 649
aklamacion 747
aksidenti teknologjik 235, 649
akte fakultative 815
akte juridike 30, 78, 100, 104, 117, 127, 128, 133, 135, 154, 161, 162, 183, 187, 189, 213, 227, 302, 416, 432, 479, 510, 583, 619, 630, 672, 683, 702, 705, 750, 766, 797, 825
akte nënligjore 23, 100, 104, 160, 186, 301, 302, 317, 343, 366, 385, 421, 511, 517, 518, 672, 739, 743, 766, 776, 783, 789
akte normative që kanë fuqinë e ligjit 537
akte që kanë fuqinë e ligjit 649
akte të detyrueshme 815
aktet juridike 28, 30, 69, 70, 71, 78, 104, 105, 110, 149, 157, 171, 182, 183, 236, 290, 482, 514, 537, 554, 579, 580, 581, 583, 596, 628, 717, 718, 727, 740, 767, 775, 817, 827
Aktet mbi Supremacinë 26
akteve komunale 776, 777, 785, 787
akteve me fuqi ligjore 99, 511, 586, 649, 650, 672
aktgjykim 282, 472, 621, 782
Aktin Final të Helsinkit 64, 65
aktvendim 356, 621
Aland 717, 728
Albert Venn Dicey 132, 135, 415, 833
Aleksandar Karagjorgjeviq 47
Aleksander Severus 86
Aleksandri i Parë 752
Aleks de Tokvil 34, 742
Algjeria 465, 467, 580, 640, 697
Almiro Rodrigues 282, 599, 622, 865
Amendamentet 30, 31, 46, 52, 77, 94, 96, 97, 110, 139, 160, 275, 449, 450, 473, 488, 494, 589, 601, 736, 859, 860
amendamentet kushtetuese federale 589
amendamentet kushtetuese jokushtetuese 95
amendamentet kushtetuese kundërkushtetuese 93, 94, 95, 96, 121
amendamentimit të kushtetutës 30, 520, 700
amendament kushtetues 483, 494, 520, 599
Amerikë 25, 28, 36, 37, 86, 118, 123, 153, 405, 406, 509, 638
Amerikë Latine 638
Amerikën e Veriut 299, 398, 668
amnistisë 456, 458, 544
Andre Sant Lage 321, 387
aneks 97, 140, 160
Angli 36, 83, 91, 147, 158, 316, 385, 397, 398, 411, 412, 414, 423, 463, 509, 548, 579, 636, 668, 742
anglikane 398
Anglisë së Re 697
ankesa kushtetuese 190, 239, 323, 595, 630
ankesat individuale 619
ankesës jo të plotë kushtetuese 189
ankesës së plotë kushtetuese 189
Anketat parlamentare 422
anomali institucionale 654
antropologjik 395
aparatit administrativ 659
Apartheid 65
Apencel 298, 371
Apenine 714
apolitik 556, 751

Arabia Saudite 198, 299
Arbitrazhat 550
Arend Liphart 439
Argjentina 38, 465, 606, 709
aristo-demokraci 655
Aristoteli 399, 686, 694
Armatën e Kuqe 173
Asambleja e Përgjithshme e OKB-së 171
Asamble Nacionale 416
Asamblenë Kushtetuese 83, 714
asociacionet 781, 799
Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe 721
Athinë 78, 298
Atifete Jahjaga 94, 473, 476, 481, 782
Atlantikut xviii, 44, 49, 83, 91, 118, 147, 659
Auditori Përgjithshëm xvii, 662
Aurela Anastasi 34, 39, 43, 106, 107, 108, 224, 341, 725, 790, 833, 838
Australia 198, 205, 217, 312, 579, 610, 679, 698, 699, 726, 845
Austria 38, 57, 96, 120, 206, 321, 323, 419, 426, 433, 465, 469, 508, 547, 585, 586, 598, 600, 601, 606, 612, 699, 701, 746, 907, 911
Austro-Hungaria 42, 43, 44, 690, 835
automatike 422, 437, 438, 509, 530, 744
autonome 42, 50, 52, 53, 54, 55, 57, 58, 76, 101, 108, 117, 134, 136, 142, 144, 288, 379, 380, 393, 394, 460, 461, 472, 478, 504, 511, 513, 517, 540, 552, 553, 567, 570, 572, 573, 588, 589, 590, 591, 592, 594, 617, 627, 629, 630, 633, 634, 635, 653, 671, 680, 694, 698, 700, 706, 710, 711, 713, 714, 715, 716, 723, 725, 726, 727, 728, 729, 732, 733, 734, 735, 736, 737, 740, 741, 754, 791, 806, 817, 827, 828
autonomi 39, 56, 146, 185, 215, 220, 291, 325, 377, 380, 397, 551, 552, 586, 589, 606, 654, 680, 681, 682, 683, 700, 706, 713, 714, 715, 717, 720, 722, 723, 724, 725, 726, 727, 728, 729, 730, 732, 733, 734, 735, 737, 738, 739, 740, 741, 762, 763, 787, 792, 793, 794, 827, 828, 830
autonomia administrative joterritoriale 722, 723, 826
autonomia ekonomike 727
autonomia e universitetit 249, 250, 268
autonomia financiare 719, 740, 763, 809
autonomia funksionale joterritoriale 722, 826
autonomia institucionale 727
autonomia personale 727
autonomia tradicionale joterritoriale 722, 826
autonomi joterritoriale 722, 723
autonomi joterritoriale me të drejtë vetëmenaxhimi 723
autonomi kulturore 291, 722, 727
autonomi normative 725, 793
autonomi politike 185, 681, 714, 717, 727, 733, 792, 830
autonomi regjionale territoriale 146
autonomi simetrike 730
autonomi territoriale asimetrike 730
autonomi të vërtetë politike 683
autoritet e pavarura 655, 658, 659, 676
autoritet e pavarura rregullative 655, 659, 676
Autoriteti Civil i Aviacionit 646
Autorizimet kontrolluese të kuvendit 822
Avokati Popullit xvii, 575, 576, 577, 662, 664, 666
Avokatura 139, 552, 558
Azi 38, 351, 638
aziatike 38, 149, 409, 737, 828
Azores 726, 728

B

Badinter 113, 324, 440, 627, 699, 700, 706, 798, 838, 854
Ballkan 39, 40, 42, 59, 134, 618, 674, 731, 737
balotage 318
Bangladesh 682
Banka Qendrore xvii, 662, 664, 666
Bankën Popullore 665
Bankën Qendrore Evropiane 658
Bank of England 653
Banovina Kroate 688, 752
Barazia 182, 183, 222, 281, 289, 476, 721, 765, 859
barazia politike 183
Baruh de Spinoza 147
bashkëpunimin dhe ndihmën financiare 719
Bashkësia Shtetërore Serbi – Mali i Zi 79, 80, 629
bashkësi autonome 715
bashkësie territoriale 722
bashkësinë politike 30
bashkësi politike simetrike 712
bashkësitë lokale 146, 307, 366, 753, 806, 812
bashkësitë territoriale 144
Bashkimi Ekonomik Evropian 691
Bashkimi Evropian xi, xvii, 113, 322, 689, 691
Bashkimi sindikal 254
Bashkimi Sovjetik 426, 464, 693, 696, 729
Baskia 715
Batasuna 382, 383
Bazel 714
Behgjet Pacolli 483, 493
Belgjika 25, 125, 184, 319, 426, 440, 508, 601, 606, 612, 639, 689, 693, 696, 697, 698, 730
Benajmin Konstan 403
Beograd 46, 48, 51, 56, 57, 80, 151, 167, 172, 359, 379, 388, 471, 551, 571, 589, 593, 676, 734, 739, 754, 796, 807, 833, 834, 835, 837, 839, 840, 841, 842, 846, 851, 855

Berlin 33, 40, 472, 638, 639, 839, 846, 848, 849, 850, 853
besimit 26, 83, 174, 176, 187, 191, 197, 198, 199, 203, 232, 234, 236, 237, 242, 258, 267, 290, 354, 414, 423, 512, 517, 537, 538, 539, 541, 669, 812
besimit parlamentar 517
big bang 35, 154
Bihaç 50
Bill of Rights 91, 177, 419
biologjike 195, 261, 264, 268, 304
bipatridët 217
bisedimet e Vjenës 760, 761
Bizant 464
Bjellorusisë 192, 409, 446, 480, 690, 863
Blegjika 38
Bodin 657, 679, 694, 837
Bolivinë 124
Bordi i drejtoreve 759
Bosnje-Hercegovina 91, 102, 128, 176, 312, 325, 358, 807
Bosnjë-Hercegovina 138, 433, 464, 508, 694, 696, 705, 726
Bosnje – Hercegovinë 54, 198
Bosnje-Hercegovinë 24, 59, 156, 392
Bosnje-Hercegovinës 24, 37, 39, 50, 52, 63, 134, 157, 325, 598, 673
Bosnjë-Hercegovinës 440, 598, 705, 706
Bosnje-Herceovina 130
Bota e Tretë 182
Branko Smerdel 654, 655, 834
Brazil 211, 320, 471, 701, 702, 709, 727, 745, 847, 862
Brazili 471
Bremen 709
brendshme 23, 54, 74, 77, 87, 88, 89, 106, 107, 128, 143, 149, 171, 185, 187, 190, 192, 194, 226, 230, 235, 267, 290, 291, 301, 326, 329, 330, 355, 359, 374, 380, 382, 384, 385, 391, 401, 420, 425, 427, 439, 440, 444, 454, 468, 509, 510, 515, 516, 526, 529, 539, 545, 563, 596, 598, 606, 619, 620, 623, 626, 632, 641, 643, 644, 674, 679, 686, 687, 689, 691, 694, 697, 700, 705, 706, 707, 708, 714, 731, 732, 766, 802, 825
BREXIT 375, 681, 691
Britania e Madhe 30, 37, 42, 49, 62, 154, 184, 189, 198, 307, 313, 314, 316, 318, 383, 407, 418, 468, 505, 506, 508, 510, 512, 681, 686, 688, 689, 729
Bruksel 559, 699, 720, 722, 782
Brunei 299
Brus Akerman 403
Buenos Aires 697, 701
Bujar Bukoshi 58, 594
Bullgaria 43, 96, 119, 583, 585, 606, 726, 731
Bundesgericht 584
Bundesrat 414, 584, 585, 701, 709, 710
Bundestag 321, 585
Bundesversammlung 414, 584
Burbon 118, 407, 509
Burbone 34
Burime formale 92
burime materiale 90, 91, 103, 109, 114, 115, 159, 160
burimet e të drejtës ndërkombëtare 107
burimet juridike të qeverisjes lokale 762
burimet materiale 90, 109, 114
Burimet përgjithësisht të pranuara të së drejtës ndërkombëtare 109
burimet subsidiare të së drejtës zgjedhore 330
burimeve primare të së drejtës zgjedhore 330
burim tradicional 391
Burkina Faso 137, 860
buxheti i komunës 760, 774, 777

C / Ç

Çadi 137, 409
Çamëri 41, 42
Carl Joachim Friedrich 32, 132
Çekia 319, 323, 433, 682, 694, 746
Çekosllovakia 38, 218, 580, 682, 694, 696, 701
Cemajl Kurtisi 281
cenimet e rënda 497, 498
cenimet serioze 497, 498
censurë 170, 207, 245
censusi arsimor 304
censusi i domicilit 304
censusi material 304
Centralizimi 687, 824
centralizimit të tërësishëm 687
centralizim të pjesshëm 687
centralizuara 146, 688
certifikimi i zgjedhjeve 330
çështja e kontrollit efikas dhe epërsia e organeve civile ndaj atyre ushtarake 636
Cetinja 807, 809
Chief Justice 586
Ciceroni 179, 399
Ciceronin 399
Ciceronit 25
cilësinë e kontrollit 748
cilësitë tjera gjeografike ose ekonomike 726
cilësive politike 132
cilësive të normave kushtetuese 132
cilësive të posaçme të territoreve të caktuara 726
civilo-juridike 463, 469, 512
Commissioners of Bankrupcy 653
Committee of the Whole House 425
condiction sine qua non 392
Constant, Benjamin 470, 471, 671
constitutio 25, 26, 147, 153

constitutional interpretation 136, 617, 674, 851
contra constitutionem 92
Corte costituzionale della Repubblica Italiana 585
curia regis 415

D / Dh

Danilo 79, 806
Danilo I Petroviq Njegosh 79
Danimarka 125, 133, 606, 689, 690, 729
Danimarkës 31, 38, 640
deagrarizimin 742
decentralizim 146, 679, 681, 686, 704, 713, 714, 716, 718, 720, 723, 725, 735, 736, 737, 739, 761, 762, 797, 799, 807, 826, 828
decentralizim asimetrik 737, 828
Decentralizimi i pushtetit 146
decentralizimit politik 718, 725, 750
decentralizuara 146, 681, 712, 725, 739, 744, 828
de facto 42, 56, 58, 99, 218, 364, 592, 593, 594, 606, 722
Dega e Posaçme 589
Dega Kushtetuese 590
degën e katërt të pushtetit 657
Degës së Posaçme 589, 590
Degës së Posaçme Kushtetuese 589
dëgjueshmërisë pa kundërshtim 637
Dejton 59
de jure 56, 593, 721, 722, 826
deklarata 93, 114, 171, 177, 189, 211, 289, 291, 335, 368, 421, 456, 458, 463
Deklarata e 2 korrikut 324, 325
Deklarata e datës 17 shkurt 2008 380
Deklarata e Pavarësisë 47, 54, 68, 77, 127, 128, 156, 172, 288, 592, 736
Deklarata e Pavarësisë e datës 17 shkurt 2008 47
Deklarata e Pavarësisë së Kosovës 54, 156, 592, 736
Deklarata e Popullit Punues 173, 212
Deklarata e Shtetit Virxhinia 168, 172
Deklarata e të drejtave të gruas dhe qytetares 173
Deklarata e të drejtave të njeriut dhe qytetarit 172, 288
Deklarata Kushtetuese 58, 755
Deklarata mbi shpalljen e RFPJ-së 51
Deklarata për të Drejtat e Liritë e Njeriut dhe Qytetarit 28, 91
deklaratat 41, 43, 91, 97, 114, 171, 172, 194, 422
Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut xvii, 105, 171, 544
Deklaratën e 2 Korrikut 156
Deklaratën e Pavarësisë 68, 75, 103, 128, 158, 172, 182, 440, 597, 670, 724
Deklaratën Kushtetuese 755
Deklaratën për Kosovën si njësi konstitutive Jugosllavisë 324
Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut 72, 300
Deklaratës Franceze për Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit 40
Deklaratës së Pavarësisë 42, 47, 75, 77, 103, 127, 160, 440, 597, 860
deklarativ 27, 28, 42, 250, 375, 444, 450, 451, 620
dekolonizimit 38, 49, 57, 507
dekoncentrim 146, 798
dekoncentrimit 146, 686, 687, 716, 750, 751, 795, 806, 819, 824, 829
dekoncentrimit të pushtetit 751, 819, 829
dekrete me fuqi ligjore 115, 468, 511, 539
dekretet 104, 109, 111, 114, 488, 539, 581, 672, 733
dekreteve me fuqi ligjore 511, 539, 672
dekreti 104, 234, 432, 443, 578, 647, 782
delegimit 326, 365, 511, 560, 654, 758, 811, 836
delegimit të pushtetit publik 654
demokracia komunale 742
demokracia konsociacionale kosovare 326
demokracia përfaqësuese 384, 658
demokraci konsociacionale 128, 284, 439, 440
demokracinë konsiciacionale 829
demokraci parlamentare 64, 404, 472, 517, 521
demokraci përfaqësuese 370
demokracisë konsociacionale 112, 128, 129, 130, 139, 162, 332, 439, 440, 441, 442, 474, 486, 525, 530, 627, 670
demokraci të drejtpërdrejta 370
demos 148
dënimi me vdekje 187, 191, 192, 240, 251, 257, 290, 293, 582
deputet 306, 307, 308, 309, 315, 317, 320, 326, 351, 353, 355, 360, 363, 365, 418, 437, 438, 446, 447, 454, 456, 457, 458, 459, 461, 462, 466, 467, 498, 506, 537, 588, 615, 631, 670, 769, 796
derogimi 99
detyrime konkrete kushtetuese 269, 270, 271, 272, 273, 274
detyrime konkrete të qytetarëve 269, 271, 272, 273
detyrime shprehimore kushtetuese 270, 271
detyrimi i përgjithshëm 269, 271, 272, 273, 640
detyrim pozitiv 516
detyrim pozitiv i qeverisë 516
dhënien e betimit 409, 418, 466, 493, 625
Dhoma e lartë 412, 470
Dhoma e Popujve 51
dhoma e ulët 420, 429, 430, 432, 508, 585
Dhoma Federative 51
Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar 139, 558, 673
Dhomën e Deputetëve 307
Dhomën e Kombeve 733

dhomën e lartë 307, 386, 430, 709
Dhomën e Lordëve 307
Dhomën e Përfaqësuese 307
dhomën e sipërme 417, 700, 701, 703, 709, 714, 715, 729, 730, 826
dhomën e ulët 307, 386, 417, 430, 507, 710
dhomës së lartë 419, 467, 710
Dhomës së përfaqësuesve 410, 412
D'Hondt 321, 343, 353, 357, 801, 851
diferencimin institucional 653, 675
diferencimit institucional 653, 656, 657
diferencimit të vazhdueshëm institucional 656
Digi-n 403
Digjesta 90
dijes objektive 656
Dik Marti 559
diktatoriale 405, 471, 506
diktator i Perusë 689
diktaturës së 6 janarit 752
dimension juridiko-penal 628
dinastisë Romanov 173
dinjiteti i njeriut 210, 225, 234, 236, 239, 261, 270, 273, 293
disa faktorë 135, 392, 467, 679, 823
disa kushteve 205, 581
diskonitinuitet kushtetues 124
diskontinuiteti 124, 161
diskrecion 451, 452, 472, 478, 479, 480, 481, 486, 514, 527, 584
diskrecion të butë 452
diskriminim 62, 174, 176, 183, 184, 204, 205, 210, 223, 225, 230, 232, 238, 243, 279, 280, 287, 291, 304, 361, 392, 480, 494, 733, 734
Diskriminimi 183, 222
diskriminimi pozitiv 183, 219, 287
Diskutoni 153, 154, 155, 156, 157, 158, 159, 160, 161, 162, 288, 289, 290, 291, 292, 293, 294, 385, 386, 387, 667, 668, 669, 670, 671, 672, 673, 674, 675, 676, 823, 824, 825, 826, 827, 828, 829, 830, 831
dispozita mbi amendamentimin 130
dispozitave të paamendamentueshme kushtetuese 120
diversifikimin 655
doktrina austriake e të drejtës publike 142, 162
doktrina mbi amendamentet jokushtetuese 583
Dokumenti i Kopenhagës 322
dorëheqja 497, 509, 512, 529, 547, 624
dorëheqje 92, 353, 374, 412, 419, 422, 432, 433, 451, 452, 455, 459, 497, 502, 503, 507, 509, 512, 529, 534, 535, 538, 539, 540, 541, 542, 560, 561, 562, 563, 565, 608, 612, 624, 628, 768, 771
draft amendamenti kushtetues dhjetë 494
Drajfus 188
drejta e pronës 180, 222, 247, 253, 277, 649
drejta e vetos 430, 669, 693
drejta e vetos absolute? 669
drejta e vetos së thjeshtë 669
drejta kushtetuese v, xv, 23, 27, 34, 37, 55, 82, 83, 84, 85, 86, 87, 88, 89, 90, 93, 96, 106, 107, 108, 114, 136, 153, 154, 158, 159, 180, 224, 290, 341, 404, 428, 471, 504, 551, 592, 639, 652, 655, 725, 790, 835, 838, 907, 908
drejta ligjore 180, 212, 274
drejta për demokraci 204
drejta për grevë 89, 186, 213, 255, 263
drejta për sigurim social 249
drejta për strehim 274, 275, 276
drejta për vetëvendosje të jashtme 700
drejta sociale 89, 181, 247, 289
drejtat dhe detyrat e qytetarëve ndaj mbrojtjes së vendit 639
drejtat e njeriut vi, 25, 29, 30, 31, 40, 58, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, 69, 71, 72, 80, 84, 85, 88, 93, 94, 95, 98, 99, 102, 104, 107, 112, 114, 116, 121, 122, 128, 129, 130, 131, 132, 134, 138, 139, 141, 142, 147, 148, 149, 150, 152, 167, 168, 169, 170, 171, 172, 174, 176, 177, 178, 179, 180, 181, 183, 184, 185, 188, 190, 191, 192, 194, 212, 216, 219, 220, 221, 223, 224, 225, 227, 229, 230, 231, 232, 233, 234, 235, 236, 237, 238, 239, 256, 260, 261, 263, 265, 267, 269, 270, 272, 273, 274, 279, 282, 285, 287, 289, 290, 291, 292, 294, 297, 323, 380, 392, 439, 441, 461, 463, 511, 544, 581, 582, 587, 594, 628, 633, 642, 644, 652, 665, 666, 704, 731, 807, 809, 835, 913
drejta të privatësisë 243
drejta të pronësisë mbi pronën e paluajtshme 274
drejtat personale vi, 140, 169, 174, 178, 179, 191, 201, 209, 243, 261, 262, 265
drejtat politike vi, 140, 174, 178, 179, 184, 191, 204, 205, 219, 260, 263, 265, 267, 274, 275, 276, 307, 587, 696
drejtave subjektive publike 178, 289
drejtave të ndryshme konkrete që i ka në disponim 468
drejtë absolute 57, 192, 193, 197, 290, 300
drejtën aktive zgjedhore 205, 244, 254, 303, 465
drejtën anglo-saksone 426, 470, 671
drejtën e punës 246
drejtën e vetos 54, 103, 412, 427, 430, 441, 467, 468, 591, 710, 745
drejtën e vetos së thjeshtë 430
drejtën pasive zgjedhore 205, 244, 254, 304, 418, 465, 668
drejtën për arsimin 264, 718
drejtën për grevë 247, 292
drejtën për jetë 170, 171, 174, 191, 193, 251, 267, 290, 293
drejtën për miratim të ligjeve 511

drejtën për qasje në informata 263
drejtën për siguri sociale 215
drejtës hyjnore 25
drejtësia sociale 129, 222, 228, 248, 731
drejtës natyrore 167
drejtës penale materiale 88
drejtës private 86, 89, 302, 406
drejtës publike 23, 26, 82, 84, 86, 142, 143, 153, 159, 162, 302, 504, 598, 605, 715, 723, 736, 742
drejtës së përgjithshme ndërkombëtare 105, 107
drejtës së zgjedhjes vii, 302, 303, 304, 305, 311, 322, 323, 324, 329, 340, 355, 366, 367, 385, 386
drejtës së zgjedhjeve 586
drejtës zgjedhore materiale 301, 329, 385
Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë 525, 646
drejtorive komunale 759, 773
Dubrovnikut 463
duhet të ketë një përmbajtje të caktuar 448, 670
Durmitorit 55
Dy 44, 80, 90, 117, 118, 125, 131, 136, 161, 173, 174, 185, 209, 253, 276, 287, 288, 318, 329, 345, 347, 351, 373, 410, 420, 444, 470, 472, 475, 483, 484, 486, 490, 516, 518, 527, 530, 557, 561, 564, 568, 628, 638, 639, 648, 669, 671, 680, 707, 710, 721, 734, 782, 823
dy grupe 104, 127, 351, 451, 464, 468, 670, 671, 699, 749
dy kushte 214, 244, 291, 417, 492
Dy përbërje të parlamentit 125, 161
dy sesione 446, 453, 461
dyshkallësh 683, 746
dyshkallëshe 188, 427
dy situata 419
dy teknika të amendamentimit 97, 160
Dyverzhe 299

E

edikt 26
Edikti i Fontanëblës 26
Edikti i Nantes 26
Edmond Burke 382
e drejta administrative 87, 404, 428
e drejta aktive zgjedhore 253, 300
e drejta buxhetore e parlamentit 422
e drejta e anulimit 685
E drejta ekonomike 89
e drejta e mbrojtjes 216, 244, 258, 751, 829
e drejta e ndërmarrësisë 247
E drejta e organizatave ndërkombëtare 102
E drejta e peticionit 268, 785
E drejta e trashëgimisë 89
E drejta e trashëgimit 263
e drejta e votës 174, 206, 262, 299, 300, 306, 385, 434
e drejta e zgjedhjes 253, 286, 299, 302, 303, 304, 323, 384, 385, 386, 727
e drejta familjare 89
e drejta kushtetuese xv, 23, 27, 37, 82, 83, 84, 85, 86, 87, 88, 90, 93, 153, 154, 158, 159, 290, 404, 428, 504, 907, 908
e drejta në eutanazi 193, 290
e drejta në vetëqeverisjen lokale 809
e drejta pasive zgjedhore 253, 254, 300
e drejta për ankesë 202, 204, 241, 277, 292, 407, 549, 551, 556
E drejta për informim vii, 312, 334
e drejta për mbrojtje 187, 195, 202, 240, 249, 549, 551
E drejta për ndihmë juridike 268
E drejta për ndihmë materiale 213
e drejta për pension 213, 249
e drejta për pjesëmarrje në jetën kulturore 216
e drejta për qenë i zgjedhur 302
e drejta për shtetësi vi, 180, 187, 217, 218, 223, 225, 226, 229, 239, 266, 291, 652, 704, 825
e drejta për shtetësi të dyfishtë 704, 825
e drejta për sigurimin social themelor 249
E drejta për subjektivitet juridik 266
e drejta për të zgjedhur 302
E drejta zgjedhore vi, 204, 205, 206, 244, 291, 300, 302, 329, 366
E drejta zgjedhore në Kosovë 329
E drejta zgjedhore serbe 366
e drejtë e përgjithshme 170, 205, 206, 299, 304, 386
e drejtë e qytetarëve 334, 740, 809, 817, 828
e drejtë relative 192
e drejtë shtetërore 84, 87
e drejtë vetoje suspensive 480
e drejtë zgjedhore procedurale 301
Eduardit 423
Eduskunta 414
Edvard Hagenbah Bishof 320
efektet juridike 620, 631
efektivitetit 239, 250, 283, 763, 780
efikasitetit 239, 250, 283, 427, 763, 780, 783, 805
eforati i ri 654
eforatin spartan 654
e fshehtë 206, 254, 306, 309, 329, 369, 790
Egjiptit 38, 639
eklezia greke 297
ekstraterritorialitet të plotë 737
Ekuadorin 124
ekzekutivi 73, 104, 107, 111, 115, 125, 133, 144, 152, 393, 404, 405, 406, 408, 409, 411, 416, 427, 428, 434, 448, 452, 467, 482, 513, 545, 632, 653, 659, 707, 710, 747, 750, 773, 774
ekzekutivi federal 707, 710
ekzekutivo-politik 403, 406

Ekzistojnë periudha kohore dhe situata kur parlamenti nuk mund të shpërndahet 669
Ekzistojnë periudha kohore kur parlamenti nuk mund të shpërndahet 433
Elbrixh Xhery 316
elemente konstituive të shtetit 145
elementi i brendshëm 91, 151, 706
elementi i jashtëm 151
elementin juridik 391
elementin personal 144, 162, 391
elementi sintetik 151
element material 143, 144, 162
elitave 657, 807
elitist 658
Elizabetë e Dytë 689
Emerik de Vatel 692
Emiratet e Bashkuara Arabe 640
emrit 26, 52, 58, 77, 94, 136, 141, 310, 377, 528, 594, 750, 752, 822
en bloc 692, 710
Entela 789, 842
entitete me rëndësi kushtetuese 660
e Paqes 64
epistokraci 305, 386
eprorët e organeve 815
erga omnes 75, 100, 107, 127, 158, 545, 619, 620
Eseks 316
Estonia 136, 310, 341, 465, 606, 864
Etërit e Pelegrinazhit 398
Etiopia 640
etnike 40, 41, 42, 48, 50, 54, 64, 67, 71, 72, 81, 113, 128, 130, 144, 155, 218, 219, 220, 231, 233, 237, 243, 245, 267, 278, 282, 286, 288, 316, 326, 377, 439, 440, 441, 442, 474, 554, 555, 556, 557, 558, 598, 599, 621, 626, 644, 646, 675, 679, 682, 695, 696, 699, 716, 717, 724, 727, 732, 761, 762, 797, 798, 799
être 660
EULEX 556, 602
Eurojust 658
Eurpol 658
eutanazia 240
E vërteta gjyqësore 545
e Vidovdanit xviii, 39, 45, 47, 48, 82, 752
Evropë xviii, 27, 37, 38, 49, 101, 118, 126, 168, 210, 299, 324, 351, 360, 409, 411, 413, 417, 440, 444, 446, 463, 466, 490, 509, 555, 598, 600, 606, 612, 613, 633, 638, 658, 673, 691, 745, 790, 909
Evropën kontinentale 427
Evropës xvii, 38, 44, 45, 49, 65, 67, 102, 105, 107, 148, 161, 172, 176, 190, 192, 194, 219, 220, 221, 234, 262, 270, 277, 278, 288, 299, 322, 344, 352, 379, 384, 431, 446, 463, 489, 507, 509, 580, 585, 603, 605, 609, 614, 615, 641, 660, 661, 691, 701, 702, 713, 715, 716, 721, 727, 737, 742, 745, 790, 791, 865
Evropës perëndimore 299
Evropës Qendrore 322
evropian/kelsenian 61, 107, 108, 580, 603, 604, 609, 615, 616, 620, 623
ex ante 618
ex constitutionem 432, 433, 451, 669, 670
ex nunc 431
ex officio 568
ex post 618
extra constitutionem 96, 119, 120, 121, 123
ex tunc 431

F

Faktet juridike 109
faktorë të tjerë përbërës 392
Fakulteti Juridik i Dizhonit 83
Fakultetin Juridik 83, 84, 158, 633, 840, 907, 911, 913
faljes 471, 499, 544
falsifikimi i rezultateve zgjedhore 324
familja 199, 244, 255, 264, 292
FAMVe 650
Faroe 717, 728
FASH-i 648
fatkeqësie natyrore 649, 770, 779
Fatmir Sejdiu 474, 475, 477, 497, 588, 859
Faza e parë 76, 79, 81, 158, 410, 428, 448, 751
faza e propozimit 428
faza e shpalljes së ligjit 430
faza e shqyrtimit dhe votimit mbi propozimligjin 429
federata 145, 419, 421, 552, 584, 679, 680, 681, 682, 686, 692, 694, 695, 696, 697, 698, 699, 700, 701, 703, 704, 705, 707, 708, 709, 711, 729, 734, 827
Federata e Rusisë 696
Federata njënacionale 699
federatat dyanëtarshe 682
federatat e përbërjes së përzier 701
federatat shumëanëtarshe 682
Federatat shumënacionale 699
Federatës së Jugosllavisë 79
Federatës së Rusisë 57, 696, 697, 726
Fehmi Agani 326, 831
feja 41, 196, 199, 219, 223, 225, 278, 697
Fihte 655
filibuster 427, 669
Filipineve 38
Filip Vujanoviq 364
fillet e qeverisë parlamentare 509
Financimi i vetëqeverisjes lokale 749
financimin e komunave 777
Finlanda 30, 38, 133, 465, 468, 469, 606, 612, 729

Finlandës 133, 639, 641, 717, 726
Folketing 414
fons juris 90
fonte di cognizione 115
fonte di elaborazione 115
fonte di produzione 115
forca 33, 391, 404, 619, 628, 667, 674
Forcat e Armatosura të Maqedonisë së Veriut 650
forcë e tretë 655
forma demokratike 33
forma e pushtetit 42, 145, 462
forma e qeverisjes 29, 42, 145, 222, 227, 462, 711
forma e shtetit 464, 671
formal v, 29, 30, 31, 32, 35, 37, 48, 49, 56, 58, 62, 71, 73, 82, 83, 87, 92, 96, 97, 106, 109, 110, 114, 115, 119, 122, 124, 126, 147, 148, 149, 151, 153, 154, 159, 160, 161, 162, 174, 208, 210, 220, 309, 314, 324, 332, 365, 395, 401, 410, 441, 442, 448, 462, 472, 474, 475, 478, 485, 486, 487, 505, 512, 513, 522, 551, 579, 580, 581, 592, 593, 600, 603, 621, 637, 639, 685, 737, 745, 755, 759, 764
formale 32, 33, 35, 36, 43, 55, 56, 68, 78, 82, 90, 92, 103, 107, 109, 110, 111, 114, 115, 118, 124, 126, 151, 155, 159, 160, 183, 184, 189, 210, 257, 281, 303, 307, 367, 370, 371, 379, 386, 410, 416, 429, 430, 441, 444, 462, 469, 470, 472, 474, 475, 476, 478, 479, 486, 489, 561, 564, 581, 592, 604, 606, 609, 615, 639, 644, 669, 673, 685, 704, 723, 764, 778, 824
formalo-juridik 88, 220, 287, 433, 554, 582, 587
format e veçanta të autonomisë 727
formës së prerë 192, 202, 240, 241, 253, 348, 355, 436, 453, 459, 468, 543, 545, 560, 562, 563, 565, 570, 615, 624, 625, 628, 768
formës së pushtetit shtetëror 146
formula Neimeyer 320
Franca 24, 25, 37, 38, 42, 49, 62, 99, 118, 124, 125, 138, 161, 206, 218, 219, 310, 382, 407, 408, 413, 417, 418, 421, 423, 424, 426, 428, 463, 464, 467, 468, 482, 506, 507, 508, 510, 518, 547, 585, 586, 601, 606, 612, 680, 688, 716, 746
Francis Hamon 85, 381, 383, 385, 676, 836, 848
Francisko Franko 714
Frankos 405
Fredrik Karl fon Savinji 90
FSK-së 489, 645, 648, 675
Fuhrerprinzip 382
funksional 103, 146, 152, 160, 419, 437, 438, 448, 449, 495, 496, 513, 521, 533, 569, 570, 607, 609, 613, 614, 615, 666, 674, 702, 815
funksione 72, 144, 208, 217, 246, 252, 268, 287, 393, 394, 395, 403, 438, 461, 469, 470, 487, 521, 539, 540, 554, 557, 560, 561, 562, 563, 564, 565, 573, 574, 576, 606, 610, 612, 623, 637, 641, 643, 648, 650, 653, 654, 667, 674, 690, 716, 729, 735, 745, 754, 756, 805, 813, 829
funksione lokale 395
funksione socio-politike 394
funksionet e dukshme socio-politike të shtetit 394, 668
funksionet e kuadrit 813
funksionet e planifikimit 716, 813
funksione të solidaritetit 395
funksione të sovranitetit 395
funksionet e themelimit 813
funksionet socio-politike 394
funksionet zhvillimore 813
funksioneve kryesore socio-politike 395
funksioneve politike 466
funksioneve socio-politike latente të shtetit 395
funksioneve të dukshme socio-politike 394
funksioni i sovranitetit 395
funksionin ekzekutiv monocefal 747
Funksioni normativ i parlamentit 421, 669
funksioni origjinal 513
funksionit ekzekutiv 393, 413, 686, 747, 815, 816, 822
funksionit politik të shtetit 396, 660, 668
funksion tjetër publik 466, 502, 503, 539, 570, 631, 635
funksion totemik 395
funskionet normative 813
Fuqia më e lartë juridike 30, 154
fuqi ligjore 99, 109, 111, 114, 115, 116, 468, 511, 537, 539, 586, 618, 649, 650, 672, 717
fuqisë juridike 97, 120, 136, 374, 587, 633, 728
Fuqitë e Boshtit 45
Fuqive të Boshtit 45
fushata negative 313
Fushata zgjedhore 312, 334
fuzionohet 466

G / Gj

Galicia 715
Ganës 639
garancionet kushtetuese 41, 88, 195, 230, 232, 236, 241, 252, 272, 274, 278, 526, 566
garantuesit të vazhdimësisë antropologjike 395
Gazetën Zyrtare 335, 338, 339, 354, 357, 368, 369, 370, 450, 451, 588, 777, 780
Gazetën Zyrtare të Kosovës 335, 338, 339
Gazmend Zajmi 58, 325
Gestapo 643
Gizo 84
gjashtëmbëdhjetë 208, 235, 487, 585, 648
GJEDNJ xvii, 63, 102, 104, 109, 112, 130, 176, 190, 191, 221, 223, 224, 226, 227, 234, 239, 251, 257, 265, 283, 290, 292, 441, 596, 598, 602, 614
GJEDNJ-së 63, 104, 112, 130, 190, 191, 221, 223,

224, 226, 234, 265, 290, 292, 441, 596, 614
Gjendja e jashtëzakonshme 187, 238, 647, 650, 651, 652
Gjendja e luftës 652
gjendjen e jashtëzakonshme 95, 111, 234, 236, 237, 241, 426, 454, 460, 461, 490, 568, 647, 648, 649, 650, 652, 653
gjendjen e luftës 236, 460, 468, 640, 649, 650, 653
gjendjes së jashtëzakonshme 54, 55, 56, 94, 95, 100, 103, 104, 114, 115, 117, 121, 131, 140, 176, 187, 202, 223, 233, 234, 235, 236, 237, 238, 240, 247, 290, 292, 368, 380, 418, 426, 433, 434, 436, 437, 443, 444, 447, 455, 458, 459, 461, 462, 468, 490, 498, 503, 510, 511, 539, 591, 592, 619, 620, 630, 646, 647, 648, 649, 650, 651, 652
gjeografike 39, 117, 145, 155, 162, 417, 682, 695, 696, 697, 710, 715, 716, 717, 726, 819, 825
Gjermani 26, 83, 84, 94, 121, 126, 144, 158, 159, 189, 206, 208, 248, 292, 307, 309, 319, 321, 382, 402, 405, 425, 428, 430, 466, 547, 580, 585, 609, 638, 661, 682, 701, 709, 742, 908
Gjermania 38, 42, 45, 62, 124, 126, 138, 161, 218, 219, 306, 319, 397, 418, 422, 424, 430, 465, 466, 467, 505, 508, 547, 586, 587, 601, 606, 612, 679, 697, 698, 699, 701, 716
Gjermaninë 402, 418, 643, 656, 691
Gjermaninë e Vajmarit 418, 656
Gjermanisë xvii, xviii, 38, 42, 47, 124, 128, 192, 402, 440, 475, 525, 600, 608, 639, 640, 641, 711, 859, 863
gjinia 72, 196, 223, 225, 229, 257, 305, 339, 360, 363, 365
Gjorgj Jellinek 143, 401
gjuha 71, 72, 96, 112, 113, 129, 217, 219, 223, 225, 228, 278, 284, 285, 332, 356, 442, 697, 715, 767, 805
gjuhën shqipe 26, 34, 112, 119, 154, 252, 256, 410
gjuhësore 41, 50, 52, 64, 124, 128, 181, 218, 219, 220, 267, 272, 278, 282, 289, 326, 414, 439, 440, 442, 679, 682, 696, 710, 715, 717, 726, 727, 799
Gjykata e Hagës për Ish-Jugosllavi 496
Gjykata e Kasacionit 545
Gjykata e Lartë Ekonomike 553
Gjykata e Lartë e KSAK-së 590
Gjykata Kushtetues 104
gjykata kushtetuese 101, 108, 126, 189, 322, 323, 324, 397, 469, 544, 578, 581, 582, 583, 584, 586, 587, 605, 621, 704, 706, 719, 748, 750
Gjykata Kushtetuese e Afrikës së Jugut 487
Gjykata Kushtetuese e Austrisë xvii, 580
Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë 492, 517, 518, 534
Gjykata Kushtetuese e Italisë xvii, 718
Gjykata Kushtetuese e Kroacisë 97, 518
Gjykata Kushtetuese e KSAK-së 590, 591, 593
Gjykata Kushtetuese e Malit të Zi xi, xvii, 364, 629, 806
Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës x, xvii, 94, 437, 587, 588, 601, 608, 621, 622, 721, 764, 765, 858, 859, 860
Gjykata Kushtetuese e RSFJ 589, 590, 591
Gjykata Kushtetuese e RSFJ-së 589, 590, 591
Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë 493, 517
gjykata kushtetuese federale 706
Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë xvii, 736
Gjykata Permanente e Drejtësisë Ndërkombëtare xvii, 42
Gjykata Speciale 558, 559, 597, 673
Gjykata Supreme xvii, 63, 101, 136, 333, 441, 518, 545, 552, 556, 566, 569, 573, 595, 616, 672, 707, 718, 818, 860
Gjykata Supreme Amerikane xvii, 101
Gjykata Supreme e Kanadasë xvii, 707
Gjykata Supreme e Kosovës xvii, 63, 333, 441, 556, 595, 616, 860
Gjykatat administrative 550
gjykata të jashtëzakonshme 203, 545, 556, 559
gjykatat e kompetencës së përgjithshme 323, 552, 553, 750
gjykatat e kompetencës së posaçme 750
Gjykatat e kompetencës së specializuar 550
Gjykatat ekonomike 550
Gjykatat e posaçme 559
gjykata të posaçme tatimore dhe gjykata doganore 550
Gjykatat e punës 550
gjykata të rregullta 550, 584, 602
gjykata të specializuara 203
Gjykatat fetare 550
Gjykatat kundërvajtëse 550
Gjykatat martesore dhe për statusin 550
Gjykatat për të mitur 550
Gjykatat ushtarake 550
Gjykatat zgjedhore 550
gjykatë kushtetuese 61, 70, 593, 600, 656, 702, 703
Gjykatën Administrative 356, 367
Gjykatën e Përgjithshme 398
Gjykatën Kushtetuese 56, 63, 94, 98, 116, 129, 130, 222, 224, 225, 229, 232, 256, 260, 269, 280, 281, 330, 366, 382, 441, 453, 477, 483, 499, 521, 526, 587, 591, 592, 594, 595, 601, 603, 623, 629, 632, 721, 788, 793, 847, 861
Gjykatën Kushtetuese të Kosovës 63, 595, 721, 847
Gjykatën Kushtetuese të Kroacisë 594
Gjykatën Kushtetuese të KSAK-së 56, 592
Gjykatën Kushtetuese të RSFJ-së 591
Gjykatën Kushtetuese të Spanjës 382
Gjykatën Speciale 105

Gjykatën Supreme 407, 552, 733, 735, 806
Gjykatën Supreme të Mali të Zi 806
Gjykatës Administrative 355, 369
Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut 102, 104, 598, 599, 601
Gjykatës Kushtetuese xi, 56, 57, 63, 94, 107, 109, 117, 129, 141, 226, 227, 239, 242, 244, 251, 256, 260, 267, 269, 280, 281, 283, 286, 330, 436, 443, 452, 456, 458, 460, 476, 480, 483, 484, 485, 488, 489, 491, 492, 493, 494, 495, 496, 498, 499, 513, 514, 516, 517, 518, 524, 525, 528, 534, 535, 580, 587, 588, 592, 593, 596, 598, 599, 600, 602, 603, 604, 605, 606, 607, 608, 609, 610, 611, 612, 613, 615, 616, 618, 619, 622, 623, 624, 627, 631, 674, 721, 802, 859, 863, 864, 907, 908
Gjykatës Kushtetuese të Çekosllovakisë 580
Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë 494, 518, 863
Gjykatës Kushtetuese të KSAK-së 592
Gjykatës Kushtetuese të MVer 141
Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës 436, 587, 593, 907
Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë 256, 456
Gjykatës Kushtetuese të RSFJ-së 57, 588
Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë 483, 485, 491, 493, 513, 517, 863
Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë 68, 380, 434
Gjykatës në Strasburg 105
Gjykatës së Nyrembergut 109, 496
Gjykatës së Strasburgut 190
Gjykatës së Supreme 460
Gjykatës Speciale x, 105, 556, 559, 617
Gjykatës Supreme 244, 334, 336, 409, 441, 458, 459, 487, 498, 518, 536, 556, 610, 621, 703, 736, 858, 859, 863
Gjykatës Supreme të SHBA 703
Gjykatës Themelore 525
Gjykatë të Apelit 498, 525
gjykim në afat të arsyeshëm 203, 204
gjyqësia 405, 406, 473, 477, 578, 579, 580, 582, 593, 594, 600, 605, 615, 616, 618, 626, 630, 691, 751
gjyqësi kushtetuese juridiksionale 617
gjyqësisë kushtetuese x, 28, 30, 66, 101, 108, 129, 141, 189, 397, 420, 477, 551, 578, 579, 580, 581, 584, 586, 587, 588, 589, 591, 592, 593, 597, 598, 600, 601, 603, 604, 605, 606, 609, 610, 615, 618, 619, 623, 626, 627, 629, 630, 631, 632, 633, 634, 673, 674, 702, 703, 711
gjyqësisë kushtetuese komuniste 630
gjyqësori 73, 85, 107, 126, 133, 136, 141, 142, 144, 152, 188, 213, 382, 400, 401, 406, 407, 408, 411, 413, 489, 543, 580, 609, 610, 620, 632, 659, 687, 703, 795
gjysmëpresidencial 146, 393, 397, 408, 432, 462, 466, 510
Glarus 298, 371
globale 168, 395, 638, 715
globalizimit 299
Governor General of Canada 689
Graçanicës 776
grante operative 779
grantet 777, 778, 779, 805
gratë 173, 205, 213, 216, 223, 225, 247, 249, 263, 264, 292, 305, 313, 347
Grekët 40, 155
greko-bullgare 42
greko-romak 90
Greqia 38, 40, 41, 43, 65, 77, 198, 298, 307, 465, 601, 731
grosso modo 85, 159
grundnorma v, 28, 33, 42, 43, 51, 80, 119, 131, 154, 155
grupet parlamentare 421, 424, 425, 428, 444, 449
Grupi i Kontaktit 59, 62, 156

H

habeas corpus 649, 652
Habeas Corpus Act 91
Habsburgëve 689
Hagë 59, 105, 156, 559, 673
Hamburgu 697, 701
Hanoverit 505
Hans Kelsen 28, 33, 35, 90, 101, 127, 149, 154, 160, 170, 385, 400, 471, 472, 473, 578, 580, 600, 605, 615, 633, 656, 671, 673, 703, 836, 849, 853, 855, 856, 857
hapësirë të butë diskrecionale 451
hebrenjtë 41, 305
Henri Ricmond Drup 320
Henrit II 147
heqja e skllavërisë 33
heshtaku i madh 637
heshtja zgjedhore 313, 334
hetimet 175, 422, 423, 445, 511, 615
hetimet parlamentare 422, 445, 511
hetimi 410, 454, 533, 624, 641
hibrid 617, 705
hibride 399, 554, 600, 819
hierarkia e akteve juridike në krejt shtetin 729
hierarkinë e brendshme 687
hierarkinë e përgjithshme 581
hierarkisë 35, 396, 545, 550, 580, 637, 694, 704, 728, 746, 766
hierarkisë së akteve juridike 728
hierarki të akteve juridike 581
hipotekën e një hipoteze 33
historinë kushtetuese të Kosovës 47, 64, 103

historinë kushtetuese të shqiptarëve nën ish-Jugosllavi 45, 155
Hitleri 219
Holanda 25, 30, 125, 218, 341, 547, 633, 689, 746, 864
Holandë 307, 425, 432, 681
Holandës 38, 96, 639, 640, 688
homogjeniteti i organeve 684
Hong Kong 316
horizontale 86, 99, 396, 397, 462, 521, 671, 679
Horst Nimajer 321
Huan Linz 322
Hugo Grocin 399
hungarezët 50, 51, 53, 155, 591, 706, 735
Hungari 414, 468, 609
Hungaria 29, 42, 43, 44, 50, 137, 138, 198, 319, 321, 422, 428, 465, 467, 585, 587, 606, 689, 690, 835

I

Ibrahim Rugova 58, 59, 156, 326, 594
Ibrahim Rugovës 58, 594
ideale 306, 346, 729, 750, 828
identitetin kushtetues 53, 61
ideologjia e shtetit liberal 210
ideologjia liberale borgjeze 168
ideologjitë ekstreme 319
ideologji të ndryshme 404, 506
i detyrueshëm 72, 125, 130, 175, 190, 215, 255, 267, 270, 329, 374, 377, 380, 381, 392, 419, 438, 457, 468, 515, 576, 583, 668, 670, 720, 728, 787, 804
Imanuel Kantit 402
Imeachment 410
imponohen me dukjen e tyre 394
imunitet 348, 419, 420, 437, 438, 455, 461, 469, 470, 495, 500, 503, 533, 537, 538, 542, 557, 560, 566, 567, 569, 570, 573, 612, 613, 614, 624, 628, 666, 667, 669, 674, 803, 813, 821
imunitetet 420, 607, 612, 614, 618, 669, 674
imuniteteve të funksionarëve të lartë shtetërorë të Republikës së Kosovës 496, 672
imunitet funksional 419, 437, 569, 570, 613, 614, 666
imuniteti 419, 420, 437, 455, 469, 495, 496, 512, 533, 546, 548, 613, 614, 615, 624, 628, 669, 670, 674, 815
imuniteti funksional 614, 615
imuniteti i paprekshmërisë 419, 613
imuniteti material? 669
Imuniteti material 419, 437
imunitetin e paprekeshmërisë 671
imunitetin e paprekshmërisë 464
imunitetin funksional 569
imuniteti nga përgjegjësia 437, 615
imunitetin material 548, 624
imunitet i pastër funksional 533
imuniteti procedural? 669
Imuniteti procedural 419, 512
imunitetit 420, 437, 438, 458, 461, 469, 483, 495, 496, 499, 500, 520, 533, 547, 548, 567, 569, 612, 613, 614, 624, 628, 672, 674
imunitetit funksional 438, 496, 613, 614
imunitetit parlamentar 437
imunitetit procedural 437
imunitetit të përgjithshëm/absolut 613, 614
imunitet jofunksional 420
imunitet material 469, 803, 813, 821
imunitet nga arrestimi 438
imunitet nga përgjegjësia 613
imunitet procedural 419, 470
imunitet të përgjithshëm/absolut 613
in abstracto 582
inaugurimi presidentit të republikës 466
incidental i kushtetutshmërisë 582, 590
Indi 309, 312, 419, 427, 430, 466, 638, 702, 709, 711
India 57, 97, 124, 138, 139, 161, 192, 322, 430, 467, 508, 679, 682, 697, 699, 701, 704, 708, 729, 827, 834, 863
India Britanike 57
Indinë britanike 708
individuale 28, 32, 40, 58, 65, 66, 84, 104, 109, 115, 138, 149, 150, 168, 169, 172, 175, 176, 177, 180, 182, 183, 185, 189, 191, 194, 215, 219, 226, 229, 230, 232, 233, 251, 257, 258, 261, 266, 269, 278, 279, 281, 283, 287, 288, 289, 298, 299, 302, 303, 308, 309, 310, 312, 313, 363, 366, 379, 383, 386, 394, 404, 406, 428, 429, 446, 461, 464, 479, 491, 512, 513, 517, 521, 522, 523, 524, 525, 532, 581, 582, 591, 594, 602, 604, 618, 619, 620, 630, 631, 635, 657, 685, 700, 706, 717, 723, 727, 729, 731, 754, 767, 815, 817, 821, 822, 825, 827
Indonezia 124, 137, 161, 409, 727
i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi 450
in flagrantia 567
iniciativa kushtetuese 371
iniciativa ligjvënëse 428
Iniciativa popullore 371, 379
Iniciativa qytetare 804
iniciativën ligjvënëse 425
iniciativës legjislative 400, 428, 510, 515, 710
in personam 243
institucional 70, 149, 152, 250, 324, 474, 489, 494, 522, 523, 562, 629, 630, 653, 654, 655, 656, 657, 658, 659, 675, 713, 723, 727
Institucione 90
Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë xvii, 68, 758

institucioneve të pavarura 139, 144, 408, 518, 523, 654, 655, 660, 675, 676
institucioni ombrellë i vetëmenaxhimit serb 722
institucion i tërësishëm 393, 667
institucion ombrellë 736
Institutcioni Shtetëror i Revizionit 666
instituti i largimit të kryetarit të komunës 786
institutit të kryetarit të kuvendit të komunës 814
institutit të vetëmenaxhimit 737
Instrumente 422
instrumente juridike 598, 688, 719, 791
instrumentet juridike 188, 323, 517, 723, 799, 826
Instrumenti i Qeverisjes 26, 178
Instrumentin e Qeverisjes 36, 398
Instrumentin i Qeverisjes 668
integrimit euro-atlantik 722
integriteti fizik 174, 179, 191
integriteti shpirtëror 191, 196
inter alia 28, 32, 67, 249, 281, 283, 284, 293, 301, 344, 375, 483, 700, 797
interepelacioni 669
Interepelacioni 422
internalizimi 220
interneti 197
inter partes 100, 189, 190, 227, 545, 620, 627
interpelanca 422, 511
interpelancë 422, 461, 539, 540, 541
Interpelancen 539
interpelancën 422, 443, 457, 541
interpretim kushtetues 617
intervencionist të shtetit 211, 404
ipso iure 479, 514, 529, 535, 682, 822
Irani 198, 297
Irlanda 38, 312, 373, 469, 508, 606, 612
Irlandën e Veriut 373, 681
ish-BRSS-ja 57, 694
ish-Jugosllavia 45, 57, 76, 82, 114, 124, 161, 218, 325, 380, 426, 464, 465, 688, 694, 696, 706, 729, 752, 808
Ishujt Rode 398
Ishujve Kuk 690
Islamike 138
Islandën 124, 466, 689
Ismail Qemajli 724
Italia 25, 37, 38, 42, 44, 45, 62, 124, 137, 161, 206, 218, 311, 318, 319, 417, 418, 420, 421, 425, 428, 430, 465, 466, 467, 468, 469, 507, 508, 510, 512, 547, 585, 586, 587, 601, 606, 680, 713, 714, 716, 717, 719, 728, 729, 730, 746, 826, 827, 837
ius domicili 218
ius sangunius 218
Ivan Shubashiq 51
Izraeli 30, 154, 216, 319, 508, 510

J

Jahjaga 94, 473, 474, 476, 481, 483, 671, 782
Jajce 50
Jakup Krasniqi 474, 484
Japonia 45, 192, 322, 507, 508, 606, 612, 737
Japonisë 128, 432, 440, 513
Jellinek 143, 168, 172, 178, 179, 183, 288, 289, 401, 836
jeta private 199
joeligjibiliteti parlamentar 206
jo i detyrueshëm 329, 419, 668
jokushtetutshmëria 104, 582
joligjshmëria 582
joliria 193
jomazhoritare 654
Jordania 640
Jordanisë 639, 694
Josip Broz Tito 51, 730, 731, 732
Jovan Gjorgjeviq 27, 34, 55, 551, 592, 639, 837
jozgjedhshmëria 465
judeo-kristian 49, 90
judicial review 579, 617, 674
Juglindore 322
Jugosllavi 27, 34, 40, 44, 45, 47, 51, 55, 59, 97, 155, 156, 325, 373, 414, 464, 496, 501, 538, 550, 551, 591, 592, 593, 626, 627, 699, 730, 734, 735, 738, 797
Jugosllavia 45, 49, 51, 52, 57, 76, 82, 114, 124, 161, 218, 324, 325, 380, 426, 464, 465, 688, 694, 696, 706, 729, 731, 752, 808
Jugosllavia e Millosheviqit 324
Jugosllavinë komuniste 82, 629, 698, 699, 704, 710, 732, 806, 825
Jugosllavisë xvii, xviii, xix, 38, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 53, 55, 56, 57, 58, 75, 76, 77, 79, 80, 81, 82, 91, 96, 110, 131, 134, 142, 155, 156, 158, 185, 324, 325, 326, 350, 364, 365, 373, 374, 378, 433, 551, 552, 553, 588, 591, 593, 597, 629, 630, 632, 673, 679, 682, 688, 696, 699, 700, 706, 708, 730, 732, 733, 734, 735, 736, 738, 751, 752, 753, 754, 755, 767, 796, 803, 806, 807, 829, 908
Jugosllavisë Federative Demokratike 51
Jugosllavisë monarkike 82
juridike xii, xv, 23, 24, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 42, 43, 47, 55, 67, 69, 70, 71, 77, 78, 80, 81, 82, 83, 84, 85, 86, 87, 88, 89, 90, 91, 92, 93, 94, 96, 97, 99, 100, 101, 102, 103, 104, 105, 109, 110, 111, 113, 114, 115, 116, 117, 118, 119, 120, 121, 122, 125, 126, 127, 128, 129, 132, 133, 135, 136, 137, 138, 141, 144, 145, 147, 148, 149, 151, 153, 154, 155, 157, 159, 160, 161, 162, 169, 170, 171, 173, 175, 176, 177, 178, 180, 182, 183, 185, 187, 188, 189, 190, 194, 196, 198, 201, 203, 205, 206, 209, 210, 213, 216, 220, 221, 223, 227, 228,

232, 236, 237, 239, 240, 241, 244, 246, 251, 252, 254, 257, 258, 260, 261, 263, 266, 267, 268, 269, 276, 280, 283, 290, 292, 294, 300, 302, 303, 304, 307, 308, 314, 317, 321, 323, 324, 328, 329, 330, 333, 338, 344, 358, 359, 364, 366, 367, 374, 379, 385, 391, 392, 393, 394, 396, 397, 399, 402, 405, 406, 407, 408, 410, 411, 415, 416, 419, 427, 428, 429, 431, 432, 433, 438, 439, 463, 466, 469, 470, 473, 476, 479, 482, 487, 493, 510, 511, 512, 514, 515, 517, 518, 519, 520, 523, 524, 526, 529, 532, 535, 537, 542, 543, 544, 548, 549, 553, 554, 555, 556, 575, 578, 579, 580, 581, 582, 583, 584, 586, 587, 588, 590, 592, 596, 597, 598, 599, 600, 603, 604, 605, 607, 609, 610, 611, 615, 617, 618, 619, 620, 622, 623, 626, 628, 629, 630, 631, 633, 634, 635, 637, 642, 644, 652, 655, 659, 668, 670, 671, 672, 680, 683, 684, 685, 686, 687, 688, 689, 692, 698, 702, 703, 704, 705, 706, 707, 711, 713, 715, 717, 718, 719, 720, 723, 727, 728, 729, 730, 731, 734, 737, 740, 741, 743, 744, 747, 750, 751, 761, 762, 763, 764, 766, 767, 775, 782, 788, 791, 797, 799, 805, 806, 807, 808, 809, 814, 815, 816, 817, 818, 819, 820, 825, 826, 827, 829, 830, 831, 908
juridiko-kushtetues xi, 50, 57, 61, 73, 107, 123, 144, 145, 150, 157, 162, 307, 386, 393, 433, 470, 471, 472, 476, 493, 588, 633, 642, 667, 672, 675, 679, 698, 700, 701, 702, 704, 710, 711, 712, 713, 715, 716, 720, 721, 728, 732, 733, 734, 735, 736, 756, 809, 823, 825, 826, 827
juridiksione dhe kompetenca paralele 708
Juridiksioni aktual i Gjykatës Kushtetuese xi, 618
Juridiksioni dhe kompetencat e regjionit 718
juridiksionin 25, 103, 104, 125, 176, 191, 208, 210, 226, 229, 476, 477, 483, 484, 497, 556, 558, 578, 584, 593, 594, 596, 617, 618, 628, 632, 673, 674, 675, 708, 711, 713, 718, 728, 732, 743, 818, 828
juridiksionit 90, 106, 108, 111, 122, 477, 483, 484, 520, 545, 555, 556, 557, 558, 579, 593, 595, 597, 601, 616, 617, 618, 619, 621, 625, 626, 629, 660, 673, 674, 706, 707, 708, 710, 711, 712, 713, 715, 718, 719, 726, 728, 729, 743, 793, 825, 826
juridiksionit dhe kompetencës së supozuar 708, 826
juridiksionit shtesë 616
jus cogens 102, 105, 109, 127, 496
Justinianit 90

K

Kaçanik 58, 594
Kadri Kryeziu 588, 608, 609, 611, 859
Kai Aide 64, 73
Kaliningrad 697
Kalvini 398
Kameruni 136, 137
kamxhikët 425
Kanada 189, 314, 316, 375, 508, 606, 612, 636, 689, 696, 697, 702, 710, 727, 745
kancelari 424, 505, 512, 638
kandidim 205, 206, 307, 308, 386, 465, 819
Kandidimi individual 308
Kandidimi me lista zgjedhore 308
kantonet 125, 144, 298, 371, 693, 710, 711
Karagjorgjeviq 47, 48, 49, 50, 134
karakter deklarativ 28, 250, 450, 620
karakterin e dyfishtë të qeverisjes lokale 809
Karl Fridrih 32
Karl Lovenshtajn 32, 132
Karl Shmit 33, 93, 121, 127, 154, 159, 170, 471, 656, 671
Karre de Malberg 400
Karta e Atlantikut 91
Karta e Banit Kulin 91
Karta e Madhe e Lirive 178, 194, 412
Karta e Parisit 322
Karta evropiane për vetëqeverisjen lokale xvii
Karta Kushtetuese xviii, 47, 56, 80, 82, 84, 118, 134, 807
Karta Kushtetuese e Bashkësisë Shtetërore Serbi-Mali i Zi 80
Karta Kushtetuese Franceze 118
Karta Spanjolle 641
kartat kushtetuese 25, 134
Kartën e Atlantikut 49
Kartën e Madhe të Lirive 26, 36, 91
Kartën e OKB-së 44, 174, 588
Kartën kushtetuese të Serbisë dhe Malit të Zi 378
Kartës së Atlantikut 44, 91
Kartës së Madhe të Lirive 414
Kartës së OKB 68, 69, 70, 91, 174, 554
Katalonia 715
Katari 299
kategoria e 31, 98, 103, 129, 181, 278, 626, 650, 656, 758
kategori kushtetuese 199, 208, 317, 381, 545, 664, 728, 739, 748, 817, 827
kategori ligjore 648, 716, 728, 827
katekizmi i ri republikan 83
Katër 347, 351, 488, 527, 528, 557, 569
katër funksione 403
Katherin Ashton 737
katolikët 305
kelesnian/evropian 600
kërkesën për votëbesim 451
keseniane/evropiane 600
këshillat gjyqësor 407
këshillat gjyqësore 202
këshillat popullorë 753
Këshillave Lokale 646

këshillave mbretëror 504
këshillave të vendvotimeve 335
Këshilli Ekonomiko-Social 175
Këshilli Gjyqësor 456, 566, 602
Këshilli i Emërimeve në Drejtësi xvii, 562, 565, 623
Këshilli i Federatës 709
këshilli i komunës 821
Këshilli i Lartë xviii, 348, 415, 559, 563
Këshilli i qarkut 792
Këshilli i Shtetit 383
këshilli i të urtëve 415
Këshilli Kushtetues i Francës 323
Këshillin Ekzekutiv Krahinor 733
Këshillin e Sigurisë së Kosovës 646
Këshillin Federal 710
Këshill i Pavarur Mbikëqyrës 535
këshilli për marrëdhënie ndërnacionale 821
Këshilli Popullor Krahinor xviii, 733
Këshillit Gjyqësor të Kosovës 140, 443, 487, 556
Këshillit Gjyqësor të Malit të Zi 569
Këshillit për zhvillim dhe mbrojtje të vetëqeverisjes lokale 816
Këshillit Prokurorial të Kosovës 443, 488
Këshillit të Evropës 67, 105, 190, 194, 220, 221, 270, 344, 379, 609, 614, 713, 721, 865
Këshillit të Evropës për luftën kundër tregtisë me njerëz 194
Këshillit të Lartë Prokurorial 576
Këshillit të Madh 39
Këshillit të Ministrave 106, 107, 453, 454, 536, 537, 559, 561, 563, 649, 665, 792
Këshillit të Rregullimit të Territorit 795
Këshillit të Shtetit 408, 701
Këshillit të Sigurimit të OKB 595, 596, 737, 756
Kili 65, 322, 404, 405, 467, 727
Kina 38, 198, 201, 383, 418, 679, 688, 697, 727, 737
Kinën komuniste 464, 753
Kinës 38, 138, 144, 736
Kisha Anglikane 26
kishave kongregacionale 398
Kishën Autoqefale Ortodokse Greke 41
Kishën Ortodokse Serbe 721
Kishës Ortodokse Bullgare 76
klasik 38, 101, 169, 210, 287, 394, 397, 403, 408, 411, 412, 413, 432, 462, 514, 579, 580, 656, 659, 824
klauzola 96, 121, 131, 410, 723
klauzolat e përjetësisë 96, 121, 122, 126, 129, 162
klauzola të përjetësisë 131
klauzolën kosovare të përjetësisë 129, 162
klauzolë shpëtimi 762, 829
klauzolës së përgjithshme 748, 810
klonimi 240
Kneset 414
kodifikimi i kushtetutës 30
Kodi i Pjetrit 806
Kodin Zgjedhor 344, 347, 348, 349, 352, 353, 376
Kodi Penal 330, 861
Kodi Procedurës Penale 330
Kodit të Etikës 611
Kodit Zgjedhor 344, 346, 347, 376, 664
Kodi Zgjedhor xviii, 342, 343, 344, 348, 353, 376, 664, 796, 861
kohës së paqes 511, 672
kolegj elektoral 465, 671
kolegjin elektoral 409
kolektive 58, 66, 78, 149, 173, 174, 180, 213, 214, 215, 229, 230, 247, 252, 259, 278, 287, 288, 289, 291, 297, 372, 379, 428, 461, 513, 522, 524, 532, 591, 594, 628, 633, 640, 700, 706, 721, 727, 738
kolektivitetet e decentralizuara 712
kolektivitetet territoriale 712
Kolumbia e Madhe 689
komandimit të centralizuar 637
Kombeve të Bashkuara 49, 71, 75, 78, 127, 326, 554, 597, 640, 756, 860, 861, 913
kombi 40, 49, 138, 150, 218, 277, 303, 696, 699, 700, 797
kombi jugosllav 49
kombinohen mënyrat e ndryshme 547
komisione 416, 420, 424, 425, 444, 445, 449, 454, 457, 510, 653, 814
komisione ad hoc 445
komisione funksionale 445
komisione parlamentare 425
Komisionet 425, 445, 449, 454
komisione të përhershme 445, 449, 454
komisionet komunale të zgjedhjeve 333, 335, 338, 341, 357
komisioneve funksionale 445, 449
komisioneve hetimore 443
Komisioni Badinter 324, 699, 706
Komisioni i Pavarur i Medieve 662
Komisioni i Venecias xviii, 60, 156, 344, 376, 381, 613
Komisioni ndërkombëtar i kontrollit 134
Komisionin Komunal të Zgjedhjeve 336
Komisionin Zgjedhor Krahinor 370
Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve xvii, 445, 606
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve viii, xviii, 327, 328, 341, 346, 375, 436, 478, 662, 664, 865
Komisioni Qendror Zgjedhor 329
Komisioni Republikan Zgjedhor xviii, 366
Komisionit të Lidhjes së Kombeve 41
Komisionit të Pavarur të Mediave 329
Komisionit të Venecias 344, 360, 615, 713, 866
komiteti i përhershëm për komunitete dhe për

ndërmjetësim 759
Komiteti i shpëtimit kombëtar 413
Komiteti për pengimin e torturës dhe veprimeve të tjera të palejueshme 194
komiteti për politikë dhe financa 759
Komiteti për të Drejtat e Njeriut 175, 288
komitet mbi marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve 803
Komonueltit Britanik 97, 160
Komonveliti i Kombeve 689, 824
komonveltet 146
Komora 137
kompetenca 68, 73, 96, 108, 134, 176, 288, 289, 323, 330, 379, 380, 406, 409, 415, 423, 424, 427, 429, 433, 443, 444, 456, 457, 458, 460, 461, 462, 471, 476, 479, 480, 481, 487, 491, 499, 501, 502, 509, 510, 512, 513, 516, 518, 521, 524, 525, 530, 533, 536, 539, 542, 546, 550, 552, 563, 570, 571, 572, 573, 575, 586, 590, 593, 599, 600, 634, 651, 663, 665, 669, 673, 680, 682, 684, 685, 686, 687, 691, 704, 705, 707, 708, 709, 711, 713, 714, 716, 717, 718, 719, 726, 728, 740, 743, 744, 746, 748, 749, 754, 757, 763, 769, 773, 774, 775, 776, 781, 788, 789, 792, 793, 795, 800, 801, 804, 806, 811, 814, 815, 816, 818, 819, 820, 821, 825, 830
kompetenca burimore 686, 687, 711, 714, 718, 740, 749, 754, 825
Kompetenca e personelit 423
Kompetenca kontrolluese 421
kompetenca lëndore 550
Kompetenca normative 420
Kompetencat ix, x, xii, xiii, 73, 142, 354, 357, 375, 442, 443, 444, 445, 460, 476, 513, 515, 521, 526, 538, 566, 568, 602, 603, 648, 713, 748, 759, 774, 775, 788, 789, 792, 800, 803, 810, 820, 822
kompetencat e bartura 748, 829
Kompetencat e deleguara komunale 775
kompetencat e kontrollit 443
kompetencat e përcaktuara me ligj 773, 800
kompetenca të plota ekzekutive 774
kompetenca territoriale 550
kompetencat kryesore 758, 759
kompetencat në sferën zgjedhore dhe të personelit 420, 669
Kompetencat zgjedhore 443
kompetencave normative 442
kompetencave të zgjeruara 776, 778
kompetencë ekzekutive autonome? 671
kompetencën kontrolluese 420, 669
kompetencën normative 420, 669
kompetencë origjinale 552, 707
kompetencë të përgjithshme 550, 553
kompetencë të posaçme 550
komuna 114, 222, 281, 328, 330, 331, 349, 350, 352, 353, 355, 361, 450, 720, 725, 739, 742, 744, 746, 752, 753, 754, 755, 756, 760, 761, 762, 763, 765, 766, 767, 768, 769, 773, 776, 777, 778, 779, 781, 783, 784, 787, 788, 797, 798, 799, 802, 803, 805, 809, 810, 816, 818, 819, 820, 821, 829, 830
Komuna e Mamushës 762
Komuna e Prizrenit 282, 765
Komunat e Kosovës 104
komunat mesjetare 299
Komunës së Parisit 413, 743
Komunës së Prishtinës 331
Komunës se Prizrenit 764, 765, 788
komunitetet e Kosovës 64, 68, 157, 278, 435
komuniteti serb 530, 531, 723, 761, 776, 830
Konektikat 398, 697
konfederata 145, 681, 682, 692, 693, 694, 697, 707, 824
Konfederata e Zvicrës 693
Konfederatat e Polonisë 38
Konfederatës së Zvicrës 414
Konferenca e Rambujesë 59, 60, 595
Konferencës Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë 699
konfesioneve fetare 242
Konflikti i interesit 548, 661
konflikti interesit 546, 548
konfliktin e interesit 562, 609, 661
konfliktin negativ për kompetencë 586
konfliktin për kompetencë 586, 618, 629, 630, 634, 718, 751, 823
konflikti pozitiv për kompetencë 586
konfliktit të interesit 206, 438, 607, 609, 635, 662, 674, 773, 808
konflikt të interesit 438, 461, 607, 609
Kongon 689
Kongres 409, 410
Kongresi 44, 80, 118, 173, 410, 430, 463
Kongresi i Berlinit 80
Kongresi i Vjenës 118, 463
Kongresin e SHBA-së 314, 409
Kongresit 25, 44, 126, 155, 206, 373, 409, 410, 463, 470, 584, 586, 668, 709, 710, 712, 713
Kongresit të Lushnjës 44, 155
Kongresit të Vjenës 25, 206, 463
konsensus 57, 79, 133, 376, 489, 691, 693
konsociacional i demokracisë 440, 670
konstituanta 124, 161
konstitucion 26
konstitucionalizëm 27, 38, 69, 76, 82, 147, 163, 173
konstitucionalizmi liberal 28, 153
konstitucionalizmin modern 69, 123
konstitucionalizmin socialist 148
konstitucionalizmit bashkëkohor 36, 42, 73, 155, 659
konstitucionalizmit klasik liberal-demokratik 38

konstitucionalizmit liberal 32, 38, 45, 85, 171, 183, 791
konstitucionalizmit liberal-demokratik 38
konstitucionalizmit shqiptar 130, 224
konstitucionalizmit socialist 38, 148
konstitucionlizmit liberal – demokratik 183
konstitutiv origjiner 706
Konsultimi publik 783, 784
kontestet abstrakte 582
kontestet konkrete 582
kontestet zgjedhore 189, 323, 365, 586, 629, 630, 634
kontesti kushtetues x, 580, 582, 619, 673
kontest kushtetues 411, 619, 673
kontinuiteti 57, 81, 124, 137, 161
kontinuiteti kushtetues 124
kontratë kolektive 213
kontratën shoqërore 147
kontratës shoqërore 542
kontroll gjyqësor të kushtetutshmërisë 617
kontrolli apo vlerësimi paraprak i kushtetutshmërisë 583
kontrolli apo vlerësimi represiv i kushtetutshmërisë së ligjit 583
kontrolli i kushtetutshmërisë 73, 411, 586, 595, 618, 764
Kontrolli i Lartë i Shtetit xviii, 140, 664, 795
Kontrolli i mëpastajmë i kushtetutshmërisë së ligjit 583
kontrolli i oportunitetit 818
Kontrolli konkret i kushtetutshmërisë 581, 582
Kontrolli konkret i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë 581
kontrollin e ligjshmërisë së akteve juridike individuale 581
Kontrollin e zgjedhjeve 333
kontrollin operacioneve financiare 805
kontrolli parlamentar 421
kontrollit konkret të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë 673
kontrollit preventiv të kushtetutshmërisë 98, 634
kontroll jozyrtar 322
kontroll juridik 818
kontroll kushtetues 101, 479, 584, 601, 605, 617
kontroll paraprak 322
kontroll preventiv 673
kontroll profesional 818
kontroll represiv 673
kontroll të çdo emërimi 760
kontrolluese 369, 420, 421, 442, 481, 669, 670, 820, 822
kontroll zyrtar 322
konvencioneve kushtetuese 640
Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut xvii, 175, 289, 544
kooptimit 605
Kopenhagë 300
Koreja Veriore 198
Korniza Kushtetuese 61, 64, 65, 66, 67, 68, 157, 555, 758
Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë 46
Kornizës Kushtetuese 66, 67, 73, 434, 758, 760
Kornizës Kushtetuese të Kosovës 434
Kosova xii, 29, 36, 47, 50, 52, 53, 54, 55, 56, 58, 59, 61, 65, 67, 71, 74, 75, 88, 90, 93, 94, 95, 98, 102, 103, 105, 127, 128, 129, 130, 131, 142, 155, 156, 159, 176, 220, 221, 223, 224, 225, 227, 236, 237, 242, 249, 250, 255, 257, 258, 275, 280, 282, 283, 292, 312, 325, 326, 327, 328, 329, 330, 376, 380, 387, 418, 433, 440, 460, 472, 474, 478, 485, 515, 516, 517, 527, 551, 552, 555, 559, 585, 588, 589, 591, 592, 593, 594, 595, 596, 597, 598, 599, 602, 603, 605, 606, 614, 616, 627, 633, 634, 653, 669, 673, 679, 696, 699, 720, 721, 723, 724, 730, 732, 733, 735, 737, 739, 751, 755, 756, 761, 782, 800, 813, 828, 829, 911
Kostarika 96
Kostarikës 120
Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë xvii, 58, 117, 460, 593, 733
Krahina Socialiste Autonome e Kosovës xviii, 326, 553, 735
Krahinën e Vojvodinës 117, 366, 369, 379, 551
Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës 433, 669
Krahinës Autonome të Vojvodinës xviii, 116, 117, 365, 734, 818, 820, 823
kratos 148
kreu i shtetit 471
krijesë shtetërore vetëqeverisëse 742
krijon dhe zbaton politikën në shtet 504
Kristo Floqi 26, 27, 838
kritere juridike 582
kritere politike 489, 582
kriteri administrativ 315
kriteri ekonomik 316
kriteri etnik 316
kriteri formal 83
kriteri gjeografik 316
kriteri i shtetësisë 598
kriteri material 83
kriteri subjektiv 393
kriterit objektiv 393
kriteri tradicional 316
Kroacia 136, 312, 319, 325, 341, 358, 373, 417, 418, 421, 467, 469, 606, 696, 807, 864
kryeministri 92, 358, 412, 413, 467, 489, 490, 506, 509, 512, 513, 521, 522, 523, 524, 525, 526, 529, 531, 532, 533, 534, 535, 536, 537, 610, 646

kryengritje 58, 151, 207, 246, 594, 700, 779
kryeshefi ekzekutiv 758, 759, 760
Kryesia e Kuvendit 445, 446, 448, 449
Kryesia e RSFJ 710
Kryesisë së Republikës Socialiste të Malit të Zi 358
Kryesuesi i kuvendit 770, 784, 802, 803
Kryesuesi i kuvendit komunal 802
kryetari dhomës së lartë 467
kryetari i GJKK-së ose 615
kryetari i komunës 206, 758, 759, 766, 767, 769, 770, 771, 772, 773, 776, 777, 780, 792, 801, 802, 804, 814, 815, 816, 821, 822
Kryetari i Kuvendit 94, 129, 370, 444, 446, 447, 450, 455, 456, 457, 473, 488, 496, 500, 501, 503, 559, 565, 601, 859
kryetari i parlamentit 314, 426, 427, 432, 451, 467
kryetarin e GJSKos 615
kryetar i parlamentit 467
kryetari parlamentit 424, 467
kryetari qeverisë 467, 652
kuakerët 305
kuazi-amendamentim 644, 645, 675
kuazi-amendamentim kushtetutes 645
Kuba 38, 99, 383
Kuebeku 375
kufizim 25, 33, 36, 122, 144, 152, 154, 169, 182, 186, 195, 196, 197, 205, 206, 207, 232, 233, 234, 238, 241, 242, 243, 246, 259, 263, 395, 438, 465, 494, 532, 543, 711
kufizimin e përkohshëm 237
kufizim preventiv 465
kulturën politike dominante 638
kundërfirmës e qeverisë 467, 671
kundërshtimi i ndërgjegjes 199, 239
kuorumi 426, 429, 447, 450, 770, 815
kuota-Droop 320
Kuota gjinore për rezultate 329, 435
kuota-Hare 320
Kuota Hegenbah-Bishof 320
kuota Imperiali 320
kuotat e përfaqësimit 311
kuptimi i ngushtë 483, 543
kuptimin e gjerë 146, 191, 241, 317, 426, 543, 642
kuptimin formal 30, 31, 32, 37, 87, 106, 115, 147, 153, 154, 159, 474, 685
kuptimin normativ 29, 153
kuptimin politik 28, 32, 204, 205, 581, 696
kuptimi politik i kushtetutës 29, 154
kuptimit negativ 150
kuptimit sociologjik të kushtetutës 33, 154
kur numri i caktuar i zgjedhësve ose qytetarëve zgjedh një deputet 418
Kurtesh Salihu 34, 50, 58, 136, 325, 551, 589, 730, 732, 838
Kushtet e veçanta 465
kushtet formale 370, 429, 489, 581, 606, 669, 673
kushtet përmbajtësore 429, 669
Kushtetuese x, xi, xvii, xviii, 34, 44, 46, 47, 55, 56, 57, 58, 61, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 73, 74, 80, 82, 83, 84, 94, 97, 98, 107, 109, 116, 117, 118, 120, 124, 125, 129, 130, 134, 139, 140, 141, 142, 152, 157, 158, 168, 222, 224, 225, 226, 227, 229, 232, 239, 242, 244, 245, 251, 256, 260, 267, 269, 280, 281, 283, 286, 330, 333, 334, 364, 366, 375, 377, 382, 432, 434, 437, 441, 443, 452, 453, 456, 458, 460, 475, 476, 477, 480, 483, 484, 485, 488, 489, 491, 492, 493, 494, 495, 496, 498, 499, 513, 514, 515, 516, 517, 518, 521, 524, 525, 526, 528, 534, 535, 554, 555, 580, 585, 587, 588, 589, 590, 591, 592, 593, 594, 595, 596, 598, 599, 600, 601, 602, 603, 604, 605, 606, 607, 608, 609, 610, 611, 612, 613, 615, 616, 617, 618, 619, 621, 622, 623, 624, 627, 629, 631, 632, 634, 674, 714, 718, 721, 736, 741, 755, 756, 758, 760, 764, 765, 788, 793, 802, 806, 807, 833, 847, 858, 859, 860, 861, 863, 864, 907, 908, 911, 913
Kushtetuta v, xi, xii, xvii, xviii, 24, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 37, 38, 40, 41, 42, 45, 46, 47, 48, 50, 52, 53, 54, 55, 56, 58, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 75, 76, 77, 78, 79, 81, 82, 83, 92, 95, 96, 97, 98, 103, 104, 105, 106, 109, 118, 119, 120, 122, 124, 127, 128, 129, 130, 132, 134, 135, 136, 137, 138, 139, 154, 156, 157, 159, 160, 161, 170, 173, 177, 192, 194, 211, 224, 225, 226, 227, 233, 234, 235, 237, 238, 239, 240, 242, 243, 244, 247, 260, 269, 275, 277, 281, 282, 302, 325, 329, 332, 338, 343, 344, 377, 402, 430, 432, 442, 452, 454, 458, 477, 494, 518, 525, 588, 589, 591, 592, 594, 595, 598, 601, 604, 618, 639, 640, 641, 649, 654, 679, 683, 696, 699, 700, 702, 703, 706, 708, 712, 725, 728, 732, 733, 734, 735, 736, 748, 752, 755, 756, 791, 835, 861
kushtetuta demokratike 132, 134
kushtetuta derivative 132
Kushtetuta e Belgjikës 432, 640
Kushtetuta e Danimarkës 31
Kushtetuta e Degolit 132
Kushtetuta e Dhuruar 81, 82
Kushtetuta e Dimitrovit 76
Kushtetuta e Etiopisë 699
Kushtetuta e Francës xvii, 30, 31, 122, 194, 211, 402
Kushtetuta e Francës e vitit 1791 194
Kushtetuta e Hungarisë 137, 138
Kushtetuta e Indisë 97, 861
Kushtetuta e Italisë xvii, 31, 192, 640
Kushtetuta e Japonisë 432
Kushtetuta e Jugosllavisë 134
Kushtetuta e Kaçanikut xii, xviii, 46, 55, 58, 156, 325, 592, 595, 756, 861

Kushtetuta e Koresë së Jugut 494, 861
Kushtetuta e Kosovës 31, 62, 63, 64, 75, 103, 104, 105, 128, 139, 157, 160, 161, 247, 332, 338
Kushtetuta e KSAK 46, 50, 588, 679, 735, 736
Kushtetuta e KSAK-së 50, 679, 735
Kushtetuta e Malit të Zi xviii, 31, 458, 725
Kushtetuta e Maqedonisë së Veriut xviii, 31, 725
Kushtetuta e Meksikës 211, 712
Kushtetuta e Mongolisë 38
Kushtetuta e Montanjarit 37
Kushtetuta e Portugalisë 641
Kushtetuta e Prillit 81
Kushtetuta e Principatës së Serbisë 81
Kushtetuta e Rambujesë 63, 64, 65, 66, 157, 595
Kushtetuta e Regjencës 81
Kushtetuta e Republikës së Kosovës xviii, 31, 75, 127, 477, 601, 835, 861
Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë Socialiste 77
Kushtetuta e Republikës së Serbisë 56, 592
Kushtetuta e RFJ 46
Kushtetuta e RFPJ 46
Kushtetuta e RSFJ 46, 52, 53, 589, 591, 679, 706, 755
Kushtetuta e RSFJ-së 52, 53, 589, 591, 679, 706
Kushtetuta e RSFJ-së e vitit 1974 52, 53, 589, 591
Kushtetuta e RSFSR 38
Kushtetuta e Rumanisë 432
Kushtetuta e Rusisë Sovjetike 132, 211
Kushtetuta e Saint Kits dhe Nevis 699
Kushtetuta e Serbisë xviii, 31, 47, 54, 55, 60, 591, 592, 725, 734
Kushtetuta e SHBA-së 194
Kushtetuta e Shqipërisë xviii, 31, 106, 377, 452, 791
Kushtetuta e Spanjës xviii, 138, 683, 861
Kushtetuta e Suedisë 30
Kushtetuta e Turqisë 129
Kushtetuta e Vajmarit 211, 525, 639
Kushtetuta e Vidovdanit xviii, 45, 47, 48, 82, 752
Kushtetuta e vitit 1791 37
Kushtetuta e vitit 1799 37
Kushtetuta e Zhablakut 55, 60, 79
kushtetuta fleksibël 135
kushtetuta formale 33, 35
kushtetuta jodemokratike 132
kushtetuta jo të plota 134
Kushtetuta Jugosllavisë 755
kushtetuta kuvendore 133
kushtetuta modifikuese 134
kushtetuta monarkike 133
kushtetuta nominale 133
kushtetuta normative 133
kushtetuta origjinere 132
kushtetuta parlamentare 133
kushtetuta presidenciale 133
kushtetuta programatike 132
Kushtetuta Radikale 81
kushtetuta reale 132
kushtetuta republikane 133
kushtetuta semantike 133
Kushtetuta shqiptare 106
kushtetuta të dhuruara 118, 134
Kushtetutat e Klarendonit 25, 36
kushtetutat e kodifikuara 162
kushtetuta të kodifikuara 133
kushtetuta të ngurta 135
kushtetutat e pakodifikuara 162
kushtetuta të pakodifikuara 133
kushtetuta të popullit 134
kushtetutat e vendeve socialiste 148, 212
kushtetutat evropiane 25, 235, 255
kushtetutat federale 45, 76
kushtetutat Greke 39
kushtetutat politike 176
kushtetutat sociale 176
Kushtetuta Turke 81
kushtetutave rigjide 135
kushtetutave të pashkruara 133, 162
kushtetutave të shkruara 37, 133, 162
kushtetutë vi, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 32, 33, 36, 37, 38, 39, 43, 44, 45, 50, 52, 54, 58, 63, 64, 65, 76, 78, 82, 85, 87, 88, 89, 90, 92, 93, 96, 97, 98, 99, 100, 101, 102, 103, 106, 108, 118, 119, 120, 121, 122, 123, 125, 126, 131, 134, 135, 136, 138, 139, 144, 147, 148, 151, 153, 154, 157, 167, 169, 170, 171, 173, 176, 177, 178, 179, 180, 181, 183, 184, 186, 188, 189, 192, 198, 199, 200, 201, 206, 207, 208, 210, 211, 213, 216, 218, 219, 220, 222, 234, 236, 247, 248, 273, 274, 277, 289, 290, 291, 292, 293, 301, 302, 303, 304, 314, 317, 371, 378, 382, 383, 386, 396, 398, 402, 404, 407, 409, 418, 419, 421, 426, 427, 429, 431, 433, 448, 463, 464, 465, 466, 467, 468, 469, 470, 471, 473, 474, 476, 478, 504, 507, 510, 511, 514, 516, 517, 521, 533, 543, 544, 545, 547, 553, 559, 579, 581, 582, 587, 588, 589, 591, 593, 594, 598, 600, 601, 613, 614, 620, 626, 633, 637, 639, 640, 644, 647, 654, 659, 660, 661, 665, 668, 669, 675, 683, 684, 685, 689, 691, 692, 695, 700, 702, 703, 704, 706, 707, 708, 709, 711, 712, 713, 714, 716, 717, 719, 723, 728, 729, 743, 748, 754, 755, 762, 791, 794, 824, 825
kushtetutëbërës 30, 34, 35, 43, 51, 119, 121, 128, 154, 307, 406, 420, 421, 440, 442, 460, 514, 544, 669, 679, 681, 684, 703, 704, 711, 730, 825
kushtetute materiale në Kosovë 723
Kushtetutën e Bosnje – Hercegovinës 97
Kushtetutën e Brazilit 211
Kushtetutën e Direktoratit 37
Kushtetutën e Federatës Ruse 129

Kushtetutën e Federatës së Rusisë 696
Kushtetutën e Francës 132, 133, 136, 681
Kushtetutën e Ganës 639
Kushtetutën e Greqisë 138
Kushtetutën e Indisë 136, 139
Kushtetutën e Irlandës 211
Kushtetutën e Italisë 121
Kushtetutën e Kaçanikut 56, 58, 61, 64, 156, 326, 433, 588, 592, 594, 756, 829
Kushtetutën e Kanadasë 708
Kushtetutën e Kosovës v, vi, 24, 75, 103, 135, 139, 220, 329, 330, 336, 720, 735
Kushtetutën e KSAK-së 553, 590, 673, 736
Kushtetutën e Maqedonisë së Veriut 226, 291, 455
Kushtetutën e Perandorisë Otomane 39
Kushtetutën e Rambujesë 60, 64, 588
Kushtetutën e Republikës së Katërt 98
Kushtetutën e Rusisë 37, 173
Kushtetutën e Rusisë Sovjetike 37, 173
Kushtetutën e Spanjës 37
Kushtetutën e Suedisë 639
Kushtetutën e Tërnovës 76
Kushtetutën e vitit 1875 412
Kushtetutën e vitit 1990 82, 494, 817
Kushtetutën e vitit 2008 60, 64, 66, 68, 71
Kushtetutën e Zhablakut 79
Kushtetutën e Zvicrës 37, 639
kushtetutën formale 33
Kushtetutën RSFJ 1974 734, 736, 755
kushtetutës formale 33, 43, 92
Kushtetutës së Bashkimit të Republikave Sovjetike Socialiste 52
Kushtetutës së Belgjikës 693
Kushtetutës së Bosnje-Hercegovinës 24, 63, 157, 598
Kushtetutës së Francës 122, 123, 173, 382
Kushtetutës së Italisë 122, 683
Kushtetutës së Klarendonit 147
Kushtetutës së Kosovës 47, 74, 103, 129, 130, 160, 162, 220, 332, 336, 341, 387, 441, 473, 596
Kushtetutës së Mbretërisë Jugosllave 752
Kushtetutës së Portugalisë 122, 123
Kushtetutës së Rambujesë 63, 64, 65, 66, 157
Kushtetutës së Republikës së Kosovës 275, 281, 375, 476, 477, 588, 601, 621, 721, 765, 859, 860
Kushtetutës së RFJ 699
Kushtetutës së RSFJ xii, 53, 54, 55, 58, 156, 589, 591, 592, 593, 751, 755, 829
Kushtetutës së RSFJ të vitit 1974 156
Kushtetutës së vitit 1974 53, 54, 71, 433, 553, 593, 669
kushtetutë të kodifikuar 25, 103, 178
kushtetutëvënies 405
Kushtetutshmëria x, 30, 141, 580, 581
kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë komuniste 630
kusht negativ 307, 418
kusht shtesë 307
kuvendet e feudalëve 463
kuvendeve të fisnikëve 504
Kuvendi ix, xviii, 31, 43, 47, 51, 53, 54, 55, 58, 71, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 94, 103, 104, 105, 129, 131, 133, 139, 140, 158, 160, 223, 234, 281, 282, 324, 325, 326, 332, 335, 338, 342, 345, 346, 351, 353, 354, 357, 358, 361, 367, 368, 375, 378, 379, 380, 433, 434, 435, 436, 437, 441, 442, 443, 444, 445, 446, 447, 448, 449, 450, 451, 452, 453, 454, 455, 456, 457, 458, 459, 460, 461, 462, 472, 474, 475, 478, 479, 480, 481, 485, 489, 490, 491, 493, 496, 497, 498, 499, 501, 502, 503, 514, 515, 517, 518, 520, 524, 528, 529, 532, 534, 535, 536, 537, 538, 539, 540, 541, 552, 559, 561, 562, 563, 564, 566, 567, 568, 569, 570, 571, 572, 573, 575, 576, 577, 587, 590, 592, 594, 597, 600, 602, 604, 606, 608, 612, 616, 623, 626, 627, 628, 630, 631, 635, 644, 645, 646, 647, 649, 650, 651, 652, 662, 663, 664, 665, 666, 667, 670, 671, 714, 731, 733, 741, 758, 764, 765, 766, 768, 769, 770, 771, 785, 788, 801, 802, 803, 804, 805, 807, 813, 814, 819, 821, 822, 835, 841, 858
Kuvendi i ASNOM 78
Kuvendi i Kaçanikut 433, 434
kuvendi i komunës 281, 755, 767, 768, 772, 774, 776, 785, 786, 788, 801, 809, 813, 815, 816, 817, 821, 822
kuvendi i konfederatës 692
Kuvendi i Kornizës 434
Kuvendi i Kosovës ix, 54, 71, 103, 104, 160, 324, 325, 326, 335, 338, 433, 434, 436, 444, 446, 472, 478, 489, 496, 514, 597, 606, 662, 670
Kuvendi i KSAK-së 590
Kuvendi i Lidhjes së Prizrenit 433
Kuvendi i Malit të Zi ix, xviii, 80, 131, 378, 458, 631, 807
Kuvendi i Përkohshëm Përfaqësues Popullor 47
Kuvendi i Podgoricës 79, 158
Kuvendi i Prizrenit 433
Kuvendi i RSFJ-së 53
Kuvendi i Serbisë ix, 368, 379, 380, 460, 635, 652, 733
Kuvendi Komunal i Prishtinës 758
Kuvendi Kosovës 332, 435, 480, 490, 670
Kuvendi Kushtetues 43, 51
Kuvendi Kushtetues i Vlorës 43
Kuvendi Maqedonisë së Veriut ix, 455, 628
Kuvendin e Bunjajt 433
Kuvendin e Kosovës 63, 94, 327, 328, 329, 330, 331, 332, 334, 337, 434, 435, 441, 442, 446, 451, 478, 479, 480, 493, 515, 528, 531, 559, 600, 602, 670, 782, 913
Kuvendin e KSAK-së 589, 591

Kuvendin e Lidhjes së Dytë të Prizrenit 433
Kuvendin e Malit të Zi 113, 360, 361, 458, 501, 630, 632, 816
Kuvendin e Maqedonisë së Veriut 455, 568
Kuvendin e Serbisë 142, 367, 380, 460, 541, 635
Kuvendin Nacional 307, 318
Kuvendin Popullor të Republikës së Serbisë 733
Kuvendi Popullor Serb 81
Kuvendit Kushtetues të Vlorës 42
Kuvendit Parlamentar 705
Kuvendit të Kosovës 91, 94, 104, 129, 324, 326, 328, 329, 332, 335, 340, 367, 434, 435, 436, 437, 438, 439, 442, 444, 446, 447, 474, 476, 480, 482, 488, 491, 493, 496, 513, 528, 531, 532, 535, 588, 596, 614, 645, 663, 736, 755
Kuvendit të Krahinës Autonome të Vojvodinës 365
Kuvendit të KSAK 58, 433, 591, 594, 755
Kuvendit të KSAK-së 58, 591, 594, 755
Kuvendit të Malit të Zi 113, 131, 360, 361, 378, 570
Kuvendit të Maqedonisë Socialiste 77
Kuvendit të Serbisë 95, 117, 131, 365, 367, 368, 370, 379, 380, 460, 461, 462, 502, 503, 540, 573, 634, 651, 667, 733
Kuvendit të Shqipërisë 107, 130, 343, 348, 453, 796
Kuvendit të Vlorës 43
Kuvend Kushtetues 39
kuvendor 37, 82, 397, 462
Kuvend të Republikës së Kosovës 433

L / Ll

Laband 401, 402
Laband-it 402
l'affaire Dreyfus 188
land 609, 709
landet 144
Laosi 38
largim nga funksioni 511
Lazim Salihu 326
Le droit constitutionnel 84
legalitet 761
legaliteti v, 145, 147, 150, 195, 202, 544
legjislacioni sekondar 774
legjislatura 332, 348, 410, 418, 493, 654
legjitim 23, 81, 119, 144, 145, 150, 151, 156, 169, 176, 213, 233, 234, 237, 292, 391, 392, 393, 416, 417, 476, 480, 616, 662, 663, 667
legjitimitet 43, 138, 217, 335, 378, 384, 411, 435, 465, 466, 515, 547, 583, 584, 747, 761
legjitimiteti v, ix, 145, 147, 150, 151, 186, 290, 392, 416, 417, 418, 434, 435, 546, 654, 668
legjitimiteti i kufizimit 186, 290
legjitimiteti juridiko-racional 392
legjitimitetin e shpërndarjes 519
legjitimitetin juridiko-racional 392
legjitimitetit 85, 150, 204, 291, 332, 364, 391, 392, 417, 532, 538, 584, 642, 668, 718, 760
lejueshmërisë së anëtarësimit paralel në qeveri dhe parlament 506
Leon Digi 401, 402, 403
Les institutitions politiques 84
letërkëmbimet 599
lëvizjet kryengritëse 143
lëvizjet terroriste 143, 382
lex mitior 241
lex posterior derogat lex priori 431, 580
lex specialis 377, 580
lex specialis derogat legis generali 580
Libani 440, 639
liberal 28, 32, 38, 39, 43, 45, 52, 85, 86, 119, 147, 149, 150, 153, 163, 171, 181, 183, 210, 211, 212, 346, 516, 588, 791
liberale-perëndimore 169
liberalo-demokratik 38, 150
liberalo-demokratike 543
Libia 99
Libisë 38, 639
Liceun e Parisit 83
liderët politikë 118, 654
lider karizmatik 392
Lidhja Akeane 695
Lidhja Deliane 695
Lidhja Demokratike e Kosovës xviii, 326, 588, 609, 621, 859
Lidhja e shteteve 682
lidhja Hanseatike 682
lidhja shtetërore 682
lidhje asimetrike 724
Lidhjes Demokratike të Kosovës 58, 475
Lidhjes së Kombeve 41
Lidhjes së Kombeve në Gjenevë 41
Lidhjes së Prizrenit 39, 155, 281, 433, 765
ligje kuadër 707
ligje mbi parimet bazë 707
ligje organike 97, 98, 99, 106, 111, 160
ligjërisht 75, 81, 92, 127, 143, 148, 149, 151, 175, 192, 208, 236, 242, 314, 315, 373, 447, 464, 548, 550, 624, 655, 722
Ligjet 81, 99, 103, 110, 116, 117, 118, 125, 133, 208, 222, 427, 429, 443, 447, 450, 457, 510, 517, 554, 670, 765
ligjet federale 702, 707, 753
ligjet me interes vital 222, 375, 450, 670, 762
ligjeve kushtetuese 31, 92, 98, 103, 106, 111, 124
ligjeve organike 98, 99, 103, 106, 111, 160, 583, 598
ligjeve sistemike 808, 810
Ligji kushtetues 46, 97, 110, 160

Ligji Kushtetues i vitit 1953 52
Ligji kushtetues për zbatimin e KMVer 110
Ligji mbi të Drejtat 91
Ligjin Kushtetues të KSAK-së 553
Ligjin për GJKKos 489
Ligjin për Gjykatën Kushtetuese 632
Ligjin për Shërbim në FSK 645
Ligji për Gjykatën Kushtetuese 330, 623, 629
Ligji për të Drejtat 178
Ligji Themelor xviii, 26, 639
Ligji Themelor i Gjermanisë 639
Ligji themelor mbi dinjitetin njerëzor dhe lirinë 178
Ligji themelor mbi lirinë e profesionit 178
Ligjit Kushtetues 52, 551, 589
Ligjshmëria 544, 581
ligjshmëria e kufizimit 186, 289
ligjshmërinë e akteve individuale 581, 631
ligjshmërisë 55, 56, 73, 108, 111, 114, 142, 148, 149, 170, 187, 202, 226, 227, 256, 260, 269, 280, 321, 323, 324, 333, 367, 407, 432, 518, 525, 536, 544, 548, 555, 572, 575, 578, 579, 581, 582, 586, 589, 591, 592, 593, 595, 604, 616, 623, 627, 630, 631, 632, 634, 643, 644, 651, 661, 666, 672, 673, 674, 685, 687, 707, 717, 719, 724, 726, 736, 740, 741, 743, 748, 751, 763, 764, 777, 780, 783, 786, 787, 795, 805, 806, 811, 813, 814, 816, 817, 818, 821, 823, 827, 830
ligjvënësit negativ 101, 578, 673
ligjvënës negativ 101, 107, 160, 578
ligjvënia 30, 121, 144, 405, 408, 427, 511, 707
ligjvënies ix, 30, 83, 99, 101, 133, 237, 393, 405, 406, 409, 416, 420, 421, 427, 428, 429, 430, 438, 447, 448, 468, 480, 510, 583, 669, 709, 710, 711, 712
Lihtenshtajn 310, 425
Lindjes së Afërt 305
Lindjes së Mesme 205, 297
liria 28, 33, 88, 89, 123, 138, 141, 148, 149, 150, 153, 168, 169, 170, 172, 173, 174, 176, 178, 179, 181, 185, 186, 187, 189, 191, 192, 193, 194, 195, 196, 197, 198, 199, 201, 204, 206, 207, 208, 209, 210, 213, 215, 216, 219, 220, 222, 228, 229, 233, 234, 236, 238, 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246, 247, 250, 252, 255, 258, 261, 262, 265, 267, 268, 274, 284, 290, 299, 300, 383, 385, 401, 415, 419, 426, 453, 571, 573, 574, 575, 576, 577, 652, 653, 695, 704, 727
liria akademike 250, 255
Liria e asociimit vi, 208, 291
liria e bashkimit dhe tubimit politik 204
liria e hulumtimit shkencor 216
Liria e krijimit 264
Liria e lëvizjes vi, 195, 196, 241, 253, 262, 266
liria e lëvizjes për të huajt 195, 290
Liria e medies 245, 267
Liria e mendimit vi, 196, 197, 198, 242, 262, 267
liria e organizimit sindikal 209, 245
liria e pjesëmarrjes në punët publike 245
Liria e shprehjes 197, 204, 242, 243
Liria e shtypit vi, 206, 207, 262
Liria e tubimit 209, 246, 263
Liria e tubimit dhe asociimit 263
Liria e tubimit paqësor 246
Liria e vendosjes 195, 290
Liria personale vi, 193, 194, 240
liria politike 123, 695
liri dhe të drejta absolute 239
liri dhe të drejta individuale 180, 182, 258, 289, 591
liri dhe të drejta personale 181, 289
liri dhe të drejta politike 181, 204, 289
liri dhe të drejta që u takojnë pakicave të ndryshme 181, 289
liri dhe të drejta të statusit pozitiv 179, 289
liri e të drejta kolektive 180, 289
liri e të drejta të statusit negativ 179, 289
lirinë dhe sigurinë 265
lirinë e asociimit 208, 245, 254, 268
lirinë e lëvizjes 186, 193, 194, 195, 196, 274, 275, 277, 278
lirinë individuale 168, 657
lirisë për ushtrimin e profesionit 254
liritë dhe të drejtat e njeriut vi, 25, 29, 30, 31, 40, 60, 61, 62, 64, 65, 66, 67, 69, 85, 88, 94, 95, 98, 99, 102, 104, 107, 112, 121, 129, 131, 132, 134, 139, 141, 142, 147, 148, 149, 150, 152, 167, 168, 169, 170, 171, 172, 174, 176, 177, 178, 180, 181, 183, 185, 188, 190, 191, 192, 212, 216, 219, 220, 221, 223, 224, 225, 227, 229, 230, 231, 232, 233, 234, 235, 236, 237, 238, 256, 260, 261, 263, 265, 267, 269, 272, 273, 274, 279, 282, 285, 287, 289, 290, 291, 292, 323, 392, 461, 463, 544, 581, 582, 587, 628, 642, 652, 665, 666, 704, 807, 809
liritë dhe të drejtat e pakicave 181, 219
liritë dhe të drejtat e statusit aktiv 178, 289
liritë dhe të drejtat e statusit pasiv 178, 289
liritë dhe të drejtat e të huajve 181, 276, 289
lirive dhe të drejtave vi, 25, 26, 31, 32, 38, 40, 41, 59, 60, 61, 62, 64, 65, 66, 69, 79, 82, 85, 88, 97, 100, 102, 104, 107, 110, 112, 117, 122, 128, 129, 130, 138, 141, 147, 149, 150, 152, 157, 162, 167, 168, 169, 170, 171, 172, 173, 174, 175, 176, 177, 178, 180, 181, 182, 183, 184, 185, 186, 187, 188, 189, 190, 191, 193, 196, 197, 198, 199, 201, 203, 204, 206, 209, 210, 212, 214, 215, 216, 218, 219, 221, 222, 223, 224, 225, 226, 227, 228, 229, 230, 231, 232, 233, 234, 235, 236, 237, 238, 239, 242, 245, 249, 250, 251, 253, 254, 256, 257, 259, 260, 261, 264, 265, 266, 269, 270, 271, 272, 273, 274,

275, 276, 277, 278, 280, 282, 283, 285, 286, 287, 288, 289, 290, 291, 292, 293, 294, 323, 334, 405, 407, 439, 440, 457, 458, 459, 503, 582, 587, 591, 595, 600, 621, 629, 630, 632, 649, 655, 661, 666, 738, 754, 816, 823
lirive dhe të drejtave e lirive fundamentale 64
lirive dhe të drejtave personale 149, 168, 251, 260, 292
lirive dhe të drejtave që janë pozitive 169
lirive dhe të drejtave të njeriut vi, 26, 31, 32, 38, 40, 41, 59, 60, 61, 64, 66, 69, 79, 82, 88, 97, 100, 102, 104, 110, 117, 122, 129, 130, 138, 141, 147, 149, 150, 157, 162, 167, 168, 169, 170, 171, 172, 173, 174, 175, 177, 178, 180, 182, 183, 186, 187, 188, 189, 190, 201, 203, 215, 216, 219, 221, 222, 223, 224, 225, 226, 227, 228, 229, 230, 231, 232, 233, 234, 235, 236, 237, 238, 239, 245, 250, 251, 256, 257, 260, 261, 264, 265, 269, 272, 273, 282, 283, 287, 288, 289, 290, 291, 292, 293, 323, 334, 407, 439, 458, 459, 582, 587, 600, 629, 632, 649, 655, 661, 666, 754, 823
lirive dhe të drejtave të tyre natyrore 169
listat e bllokuara 311
lista të hapura 310, 327, 342
Listat e hapura zgjedhore 312
lista të mbyllura 328, 330, 342, 345, 347, 352, 367
Lista të mbyllura zgjedhore 311
lista të pabllokuara 311
Listat e posaçme zgjedhore 312
Listat krejtësisht të mbyllura 331
listën e votuesve 333, 336, 337
Lituania 425
Lituanisë 38, 491, 498, 514, 517, 528, 863
llambë ultra-violete 337
LLloku 152
llojet qeverisë 505, 672
lloji/modeli i koalicionit qeverisës 524
llojit të akteve juridike 393
lockout 213
Londër 36, 42, 59, 156, 197, 699
Lordi Xhejms Brys 135
Luan Omari 34, 106, 107, 108, 224, 341, 725, 790, 838
Luftën e Dytë Botërore 40, 580, 714
Luftën e Vlorës 44
Luftës Civile Amerikane 694
Luftë së Parë Botërore 385
Luftës Greke për Pavarësi 40, 155
Luftës së Ftoftë 64
Luftës së Ftohtë 45, 57, 64, 106, 171, 203, 633, 638, 639, 654, 693, 731, 791
Luigji XIV 463
Luksemburg 310, 320, 716
Lushnjës 44, 155, 863

M

Madeira 728
Madhërishëm 381, 415, 504, 509
majtas apo djathtas 516
Makiavelin 399
makinerisë administrative të shtetit bashkëkohor 660
Maks Veber 391, 392
Malajzia 464
Mali Atos 726
Mali i Zi xii, xvii, 43, 45, 75, 79, 80, 81, 92, 114, 131, 135, 136, 230, 232, 286, 312, 319, 324, 325, 359, 360, 361, 364, 372, 378, 629, 632, 651, 682, 694, 696, 699, 725, 732, 735, 739, 752, 800, 806, 807
Maltë 320
Mandati ix, 74, 331, 336, 348, 354, 357, 409, 418, 419, 431, 434, 436, 452, 453, 455, 458, 461, 466, 498, 502, 503, 508, 540, 556, 558, 560, 561, 562, 563, 564, 565, 567, 569, 571, 572, 573, 598, 603, 604, 605, 631, 650, 662, 663, 758, 759, 768, 771, 772, 773, 774, 801, 803, 814, 913
mandati i detyrueshëm 419
Mandati i lirë 331, 419
mandat i lirë 438, 670
mandati lirë 438
Maqedonia e Veriut xii, xviii, 45, 75, 77, 78, 131, 136, 141, 226, 227, 232, 257, 260, 276, 284, 325, 433, 694, 696, 725, 731, 735, 796, 797, 798, 807
Maqedonisë ix, x, xi, xvii, xviii, xix, 31, 52, 76, 77, 78, 94, 108, 109, 110, 111, 112, 113, 131, 136, 226, 227, 228, 256, 257, 258, 259, 272, 276, 283, 284, 285, 291, 293, 294, 349, 350, 440, 455, 456, 457, 499, 500, 501, 515, 516, 537, 538, 567, 568, 627, 628, 632, 650, 665, 671, 725, 731, 732, 738, 797, 798, 799, 800, 801, 802, 805, 840, 863, 865
Maris Oriu 403
marketingu zgjedhor 312, 313
Markezi i Lafajetit 169
marrëdhënia e hierarkisë 396
marrëdhënia e ushtrisë me autoritetet e pushtetit civil 639
marrëdhënie juridike 182, 396, 668
marrëdhënie juridiko-publike 180, 692
marrëdhënies horizontale 396
marrëdhënies vertikale 396
marrëdhënieve juridike 741
Marrëveshja e Beogradit 46, 47, 807
Marrëveshja e Munihut 219
Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë 646
Marrëveshja e Rambujesë 46, 59, 60, 61, 62, 64, 68, 156, 157, 595, 862

Marrëveshja Tito-Shubashiq 51
marrëveshje bashkëpunimi 774
Marrëveshjen 47, 60, 64, 69, 76, 77, 131, 155, 158, 377, 555, 597, 598, 720, 807, 862
marrëveshje ndërkombëtare 66, 107, 108, 151, 186, 190, 218, 223, 224, 235, 259, 264, 274, 276, 278, 468, 481, 482, 498, 499, 510, 515, 539, 625, 649, 692, 705, 764
Marrëveshjen e Dejtonit për Bosnje-Hercegovinën 60
Marrëveshjen e Lozanës 155
Marrëveshjen e Ohrit 76, 158, 720
Marrëveshjen e Prespës 76, 77, 158, 377
Marrëveshjen e Rambujesë 69
marrëveshjes për pranim të fajësisë 546
Marrëveshjes së 14 marsit 2002 80
Marrëveshjes së Beogradit 56, 364, 378, 807
Marrëveshjes së Dejtonit 24, 37, 59, 62, 63, 97, 134, 157, 595, 598
Marrëveshjes së Lozanës 41
Marrëveshjes së Ohrit 78, 284, 377, 738, 828
Marrëveshjes së Rambujesë 60, 61, 62, 63, 64, 68, 69, 157, 595
marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare 102, 117, 160, 194, 232, 571, 764
marrëveshjet ndërkombëtare 105, 106, 107, 109, 127, 140, 226, 230, 249, 253, 260, 261, 269, 276, 277, 287, 380, 429, 443, 450, 460, 462, 476, 481, 482, 581, 583, 625, 629, 705, 739, 764, 793, 795
marrëveshjeve ndërkombëtare 66, 106, 108, 111, 223, 276, 278, 420, 450, 456, 458, 461, 481, 482, 566, 567, 586, 625, 633, 705, 718
Marsilion nga Padova 399
Martesa dhe familja 244, 255
Marti Ahtisari 74, 596, 597
Masaçusec 398, 711
Masat e jashtëzakonshme 140, 235, 648
masat e përkohshme 619, 622, 675
masave të përkohshme 537, 590, 622, 631
masën e përkohshme 634
masës së përkohshme 588, 634
matematika zgjedhore 302
materia constitutionis 23, 25, 29, 76
materia kushtetuese 23, 92, 98, 100, 105, 122, 161, 675
materia legis 76
Mauris Diverzher 408
mbikëqyrja e kufijve në mes të sektorit publik dhe atij privat 655
mbikëqyrja e punës së policisë 644
mbikëqyrje 74, 190, 313, 354, 357, 510, 519, 538, 540, 644, 721, 729, 777, 786, 805, 811, 823
mbikëqyrje e 74, 644, 786
mbikëqyrje e jashtme 644
mbikëqyrjes së ligjshmërisë 687, 719
Mbledhja e jashtëzakonshme 426, 770
Mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit të komunës 770
Mbledhja e rregullt e parlamentit 426
Mbledhja inauguruese 769
Mbledhja solemne 770
mbledhje permanente 426
mbledhje të jashtëzakonshme 425, 446, 447, 669, 758
mbledhjet e rregullta 766, 770, 784
mbledhje të rregullta 425, 669
Mbledhjet urgjente të kuvendit të komunës 770
Mbretëria e Malit të Zi 47, 57, 79, 158
Mbretëria e Serbisë 57
Mbretëria Jugosllave xviii, 45, 752
Mbretëria Serbo-Kroato-Sllovene xviii, 38, 752
Mbretëria SKS xviii, 48, 752
Mbretërinë Serbe 47
Mbretërinë Shqiptare 44, 838
Mbretit Perandor Emanueli III 44
Mbretit Zogu i Parë 44
Mbrojtësi i lirivë dhe të drejtave të njeriut 666
mbrojtja e autonomisë 740
Mbrojtja e veçantë 817
Mbrojtja e vetëqeverisjes regjionale 719
Mbrojtja juridike e vetëqeverisjes lokale 805
Mbrojtja juridiko-administrative 817
mbrojtjen e autonomisë së krahinës 741
mbrojtjes administrativo-gjyqësore 816
mekanizmat ankimorë 175
Meksikë 701, 702, 709
Meksiko 307, 323, 465, 466, 467, 679, 699, 701, 709
Meksiko Siti 701
me ligj 33, 99, 106, 107, 148, 173, 174, 176, 180, 186, 192, 196, 197, 199, 200, 203, 206, 207, 208, 209, 216, 218, 226, 228, 230, 233, 234, 235, 237, 238, 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246, 247, 248, 249, 250, 251, 252, 253, 254, 255, 258, 259, 261, 262, 263, 264, 266, 267, 274, 275, 276, 277, 278, 279, 283, 284, 292, 293, 302, 319, 322, 336, 356, 360, 361, 366, 371, 375, 381, 396, 407, 418, 426, 431, 434, 438, 439, 444, 448, 450, 453, 454, 455, 456, 457, 458, 460, 461, 462, 477, 501, 514, 524, 525, 526, 531, 534, 537, 538, 539, 540, 542, 543, 544, 545, 553, 556, 557, 558, 559, 560, 561, 562, 563, 564, 565, 566, 567, 568, 569, 570, 571, 572, 573, 574, 575, 576, 577, 578, 579, 581, 589, 590, 591, 594, 595, 596, 598, 605, 607, 611, 613, 617, 619, 623, 625, 626, 627, 634, 644, 645, 646, 647, 648, 650, 654, 660, 662, 663, 665, 667, 685, 712, 716, 720, 728, 739, 740, 741, 743, 747, 748, 750, 753, 756, 757, 763, 767, 769, 771, 772, 773, 774, 779, 781, 786, 788, 792, 793, 796, 797, 798, 800, 801, 802, 803, 805, 810, 811, 812, 814, 815,

816, 817, 818, 819, 820, 821, 824, 828
Memorandumin e ASSHA-së 53
mendimeve mospajtuese 621, 674, 675
Mendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Kosovën 68
Mënyra e zgjedhjes 546, 709
më shumë ceremoniale sesa ekzekutive 470, 671
me shumicë të thjeshtë 410, 426, 450
Mesjetë 147, 153, 412, 462, 695
metoda deontologjike 85
metoda d'Hondt 320, 360, 367
metoda dogmatike 85
metoda e interpretimit tekstual 85
metoda e shpjegimit të normave kushtetuese 85
Metoda e të drejtës kushtetuese v, 85
metoda historike 85
metoda juridiko-pozitive 85
Metoda Saint-Lague 321, 387
metoda sociologjike 86
metodat natyraliste 85
metodat pozitiviste 85
metoda Webster/Saint-Lague 321
metodën juridike-krahasimore 85
metodës politologjike 85
metropole 55, 592, 680
mëvetësinë organizative të gjykatës 545
Mexhlis 414
Mijanmar 198
Mijat Shukoviq 78, 113, 317, 359
mikro regjion 739
mikse 33
miles perpetuus 637
Millosheviqin 82
Millovan Gjillas 732
minister 504
ministri i brendshëm dhe sigurisë publike 467
Mirabosë 206
Mishels 384
Mitrovicës së Veriut 776
mocion besimi 537, 538
mocionin e mosbesimit për Kryeministrin 451
mocionin e votëbesimit të Kryeministrit ndaj qeverisë 451
mocion mosbesimi 478, 534, 535, 537
mocion votëbesimi 534
model ahtisarian i decentralizimit 761
modeli evropian/kelsenian 107, 616
modeli i bashkëpunimit 585, 602
modeli i caktimit të drejtpërdrejtë 585
modeli i zgjedhjes 585
modeli kolegjial 815
modeli monokratik-inokos 815
modelin konsociacional të demokracisë 103, 160
modelin parlamentar të shtetit të Kosovës 522, 532
modelin unitar 680
modelit evropian/kelsenian 603, 604, 615, 623
modelit evropiano-kelsenian 623, 626, 631
modelit kelsenian/evropian 551, 600, 604, 605, 610
modelit pluralist 679, 680, 725, 823
modelit të caktimit të drejtpërdrejtë 602
modelit të emërimit 519
modelit të zgjedhjes 602
model të zgjedhjes 602
modus operandi 658, 659, 660, 661
mohon besimin qeverisë 452
Moisei Ostrogorski 385
Moldavia 467, 473, 726
momenti kushtetues 23, 153
monarki 30, 34, 37, 44, 48, 79, 93, 94, 146, 158, 297, 399, 462, 464, 467, 509, 598, 688, 689, 752, 790
monarkisë absolute 463, 683, 742
monarkisë parlamentare 463, 469
Monarkisë së Francës 463
monarkitë mesjetare 463
monarkitë parlamentare 125, 134
monarkive kushtetuese 463, 485
monarkut anglez 430
monokratike 33
monopoli i dhunës fizike shtetërore 692
Monteskie 147, 397, 400, 401, 403, 405, 407, 542, 679, 694
mosha madhore 244, 299, 300, 303, 304, 364, 418, 464
Moskë 507
mosmarrëveshjeje 28, 115, 476, 578
mosvotimit të besimit 512, 541
motorit të zhvillimit ekonomik 516
mund të jenë të mbyllura 446
mund të jenë të veçanta 425
mund të jetë i detyrueshëm 125, 374, 419, 583, 668
mund të klasifikohen në dy grupe 468, 671
mund të kufizohen 176, 185, 233, 235, 236, 237, 238, 244, 246, 259, 260, 517, 649
Murit të Berlinit 49
Murmansk 697
mutatis mutandis 96, 108, 113, 159, 230, 338, 368, 376, 497, 525, 535, 615, 622, 752

N / Nj

Nansi 83
Napoleon Bonopartes 372, 471
Napoleoni 471
Napoleonit 25, 83, 118, 688
NATO xviii, 53, 61, 62, 64, 102, 105, 326, 349, 377, 434, 551, 595, 690, 691, 720, 756, 865
natyralizim 223, 303, 465

natyrën e ndarjes së pushteteve 657
Nauru 466
ndalesave konkrete kushtetuese 269, 271, 273
ndalesë kushtetuese 240, 270, 271
ndalimi i censurës 262
ndalimi i diskriminimit 176, 183, 184, 187, 220, 222, 225, 229, 270, 271, 282, 289
ndalimit të keqpërdorimit 184, 289
ndaloj punën e organizatës politike 587
ndarja horizontale e pushtetit 679
Ndarja vertikale e pushtetit 397, 679, 680, 707, 825
ndarje e kompetencës mes shtetit dhe njësisë federale 707
ndarje horizontale 396
ndarjen e pushteteve 222, 231, 393, 398, 400, 402, 654, 657, 658
ndarjen triadike 396, 661
ndarjes së pushtetit 104, 129, 133, 146, 304, 384, 397, 398, 402, 403, 404, 405, 408, 409, 419, 420, 430, 431, 438, 439, 440, 466, 476, 495, 542, 544, 578, 579, 616, 668, 669, 684, 806, 807, 808, 815
ndarjes vertikale 397, 680, 715, 720, 823
ndarjeve buxhetore 519
ndërkombëtarizimit 174, 299, 633
ndërkombëtarizuar 104, 134, 554
ndërmjetme 193, 420, 470, 471, 472, 478, 487, 556, 597, 610, 617, 619, 695, 713, 715
ndërprerja e punës 213, 432
ndërprerjen e funksionit të gjyqtarit kushtetues 631
ndërprerjes 61, 62, 188, 201, 213, 218, 246, 370, 419, 436, 467, 502, 542, 634
ndikimin sovjetik 45
ndryshimet faktike të kushtetutës 126
ndryshim të kushtetutës 95, 121, 467
ne bis in idem 88, 195, 236, 241, 252, 262, 266, 649, 652
negative 101, 181, 210, 270, 307, 313, 324, 359, 465, 578, 602, 642, 696, 744, 825
në mes të nivelit politik 519, 535, 672
nënkomisione 445
Nënkomisionit për Çamëri 41
nënshtrohet organit civil shtetëror 638
në procesin e nominimit të tyre 661
ngushtohen kompetencat 509
Nikaj 27, 789, 841, 842
Nikola I Petroviq Njegosh 78, 79
një natyre joekzekutive 476
një pushteti të tretë 655
një rol neutral 470
njëshkallëshe 427, 428, 746
Njësia e Posaçme Hetimore 563
njësitë federale 79, 97, 220, 320, 324, 396, 419, 545, 586, 668, 680, 695, 697, 698, 699, 700, 701, 702, 703, 704, 705, 706, 707, 708, 709, 711, 712, 713, 715, 726, 729, 741, 827
njësive regjionale 720, 802
njësive zgjedhore viii, 301, 302, 314, 315, 316, 351, 352, 353, 360, 361, 365, 385, 386, 709, 729
njësi zgjedhore 308, 311, 313, 314, 315, 316, 319, 320, 321, 324, 330, 331, 343, 350, 351, 352, 353, 360, 361, 365, 366, 367, 386, 416, 812
njohje de fakto 721, 826
njohje de jure 721, 826
Nju Xhersi 398
nocionin jo administrativ të regjioneve 739
nomofilaktik 545, 672
nomos 147, 162, 726
non-liablity 613
non-metropolitan districts 683
norma fillestare dhe përfundimtare 87, 159
norma themelore dhe fillestare 87, 159
normativ 29, 69, 87, 106, 136, 153, 317, 347, 392, 407, 408, 413, 421, 479, 669, 679, 680, 684, 713, 724, 725, 733, 734, 745, 755, 763, 776, 777, 791, 795, 822, 823
normative 33, 66, 77, 85, 89, 98, 102, 104, 106, 108, 119, 133, 135, 136, 137, 138, 140, 143, 154, 158, 161, 180, 191, 364, 366, 420, 421, 433, 442, 507, 537, 556, 578, 582, 625, 628, 669, 670, 695, 704, 708, 724, 725, 735, 736, 743, 744, 746, 776, 777, 790, 792, 793, 794, 804, 813, 821, 830, 856
normat mbi rregullimin e pushtetit 31
Normat përgjithësisht të pranuara të së drejtës ndërkombëtare 102
normavënësi pozitiv 583
normavënës pozitiv 673
Norvegji 307, 321, 414
Novi Pazarit 39
nuk gëzon legjitimitet popullor 547
nuk ka të drejtë të propozoj ligje 409
nuk mund të kufizohen 235, 237, 517, 649
nul 493
numërim taksativ 718, 748
nxjerrja e ligjeve 28, 729, 827

O

objektiv 85, 202, 305, 393, 474, 482, 589, 604, 607, 608, 609, 674
Objektivat socialë 293
objektive 97, 202, 312, 332, 372, 392, 441, 442, 475, 497, 547, 604, 605, 607, 608, 609, 624, 656, 674, 704
objektiviteti 546, 548
Objekt kontrolli 322, 685, 824
oblast 752, 829
obstruksioni 427, 470, 669
Odës së Avokatëve të Kosovës 557

ofrimi i shërbimeve 655, 800
ofrimit të shërbimeve 654, 763
okupim 47, 151, 694
oportuniteti 723, 751, 786
organe apolitike 751
organe kryesore 660, 691, 767
organe qendrore 680
organe shtetërore 76, 100, 303, 396, 601, 617, 660, 668, 680, 687, 716
organet e administratës lokale 811
organe të autonomisë 680
organet e autonomisë territoriale 728, 729, 750
organe të pushtetit në konfederatë 692
organe të regjionit 680
organet që kanë rëndësi kushtetuese 396, 668
organet që themelohen drejtpërdrejt me kushtetutë 396, 668
organi ekzekutiv i komunës 822
organi më i vjetër shtetëror 462, 671
Organin ekzekutiv regjional 717
organi përfaqësues 36, 134, 238, 404, 405, 406, 418, 478, 482, 505, 581, 602, 717, 743, 746, 751
organit të akuzës 568, 575, 667, 711
Organizata e Sigurisë Kolektive 690
organizata monotip 754
Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë 555
organizatë ombrellë 722
Organizatës për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë 360
organizimi horizontal 396, 668
organizimi i pushtetit 84, 133, 138, 406, 511, 655, 717, 729, 740, 746, 807, 808, 829
organizimi policor 636
organizimi vertikal 396, 668
Oriu 403, 404
Oto Majer 403, 404

P

pabarazia faktike 306
padi 188, 356, 533, 817
Pakicat kombëtare 52
pakicave kombëtare 51, 57, 77, 78, 116, 174, 176, 180, 184, 215, 218, 219, 220, 229, 250, 283, 285, 286, 287, 288, 291, 294, 312, 359, 365, 366, 367, 417, 460, 461, 649, 740, 823
pakicën kombëtare shqiptare 360
Pakistan 467
Pakistani 57, 467, 682, 708
Pakistani Lindor 682
Pakistani Perëndimor 682
Pakistanit 38, 57, 640
pakte kushtetuese 134
Pakti i Varshavës 690
Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike xix, 544
pamundësinë e kandidimit për deputet 438, 670
panachange 386
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa xix, 333
Papa 299
papajtueshmërinë e funksionit 438, 548, 569, 576, 625
Paprekshmëria e banesës 266
Paqja e Vestfalisë 25
pa rend të ditës 447
parim absolut 549
parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare 107, 286
parimeve kushtetuese 30, 139, 763, 795
parimi Badinter 627, 798
parimi i decentralizimit 686, 754, 824
parimi i dekoncentrimit 686, 716, 824
parimi i depolitizimit 637, 808
Parimi i gjykimit publik 548, 549
parimi i integritetit territorial 692, 824
parimi i kushtetutshmërisë 24, 28
parimi i legalitetit të veprës dhe sanksionit 203
parimi i ligjshmërisë 187, 643, 672, 783
Parimi i nënshtrimit të ushtrisë ndaj autoriteteve të pushtetit civil 638
Parimi i pavarësisë 544
Parimi i përhershmërisë së gjykatave 545
parimi i qeverisjes së mirë 763
Parimi i shkallshmërisë 545
parimi i shumicës 709
parimi i unitetit të pushtetit 148, 687, 725
parimi i unitetit të rendit juridik 750
Parimi ligjshmërisë 544
parimin e detyrueshmërisë së vendimeve gjyqësore 545, 672
parimin e ndarjes së pushtetit 133, 146, 405, 430, 668, 808
parimin e pavarësisë materiale 545
parimin e përhershmërisë së gjykatave 672
parimin e proporcionalitetit 237, 238, 292
parimin e unitetit të sistemit gjyqësor 672
parimi personal zgjedhor 812
parimi territorial 812
parimit të hierarkisë 704
parimit të ligjshmërisë 407, 548, 643, 795
parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve 82, 323
parimit të rivalitetit dhe konkurrencës 724
parimit të subsidiaritetit 713, 748, 774
Parimi unitetit të sistemit gjyqësor 545
Parimi zgjedhor i mbështetur në interes 812
parlament 30, 39, 44, 92, 110, 119, 126, 184, 220, 302, 307, 308, 309, 313, 315, 318, 319, 345, 347,

360, 371, 384, 386, 405, 412, 414, 416, 417, 419, 420, 421, 422, 423, 424, 425, 426, 427, 428, 429, 430, 444, 462, 465, 466, 489, 504, 505, 506, 507, 508, 511, 512, 517, 533, 542, 546, 583, 644, 668, 684, 719, 729, 746
parlamentarizmit evropian 583
parlamentarizmit klasik 408, 411
parlamenti 85, 99, 104, 115, 116, 118, 119, 124, 125, 134, 189, 315, 318, 319, 323, 326, 344, 346, 351, 352, 396, 397, 400, 404, 405, 406, 412, 413, 414, 415, 416, 417, 418, 419, 420, 421, 422, 423, 424, 425, 426, 427, 428, 430, 431, 432, 433, 464, 469, 489, 508, 509, 510, 511, 512, 517, 518, 525, 542, 548, 579, 581, 582, 606, 607, 633, 638, 668, 669, 672, 684, 685, 703, 704, 707, 712, 717, 729
parlamenti anglez 414
parlamenti dydhomësh 412, 703
Parlamentin e BE-së 297
parlamentit ix, x, 34, 82, 92, 99, 100, 111, 113, 116, 125, 134, 152, 161, 189, 300, 301, 306, 307, 314, 319, 355, 360, 381, 383, 384, 386, 400, 404, 407, 409, 411, 412, 414, 415, 416, 417, 418, 419, 420, 421, 422, 423, 424, 425, 426, 427, 428, 429, 430, 431, 432, 433, 438, 443, 447, 451, 465, 466, 467, 468, 469, 471, 488, 498, 504, 505, 506, 507, 508, 509, 510, 511, 512, 513, 518, 525, 531, 547, 583, 585, 586, 587, 638, 640, 668, 669, 672, 681, 684, 700, 701, 703, 709, 710, 712, 714, 715, 717, 730, 826
parlament njëdhomësh 444
parlare 414
Partia Demokratike e Kosovës xix, 608, 611
partia komuniste 593, 630
partikularizëm 463
Partisë Komuniste Jugosllave 51
Partisë Komuniste të Jugosllavisë 753
pater familias 306
Paul Laband 401
Pavarësia 225, 393, 407, 544, 548, 809
Pavarësia e komunës 809
pavarësia personale 544
pavarësia reale 544
pavarësinë e dytë 434
pavarësinë institucionale 545
pavarësisë x, xii, 23, 24, 39, 42, 43, 45, 47, 57, 61, 70, 71, 74, 75, 78, 80, 103, 113, 114, 128, 130, 131, 132, 134, 138, 139, 146, 155, 157, 158, 172, 197, 202, 220, 228, 275, 305, 324, 325, 327, 328, 329, 357, 377, 378, 387, 433, 440, 478, 487, 494, 544, 545, 548, 551, 554, 556, 557, 587, 596, 597, 600, 601, 602, 603, 605, 606, 607, 608, 614, 617, 628, 654, 661, 662, 672, 673, 674, 687, 700, 701, 706, 719, 720, 724, 736, 743, 744, 746, 749, 751, 755, 756, 761, 807, 808, 827, 828, 829, 860
pavarësisë së mbikëqyrur x, 24, 71, 75, 103, 139, 158, 597, 600, 602, 606, 617, 674
pavarësi të kombinuar 730, 828
Pelegrino Rosi 84, 87, 159
Peloponezin 695
penalo-juridike 88, 241, 292, 469, 512, 542, 549, 628
Perandoria Austro – Hungareze 57
Perandoria Otomane 57
perandorinë 464, 694
Perandorinë Britanike 726
Perandorinë Osmane 43, 737, 828
Perandorinë Ruse 726
Perandorisë Austrohungareze 752
Perandorisë Austro-Hungareze 580
Perandorisë së Shenjtë Gjermane 682
përbërja e zgjeruar e gjykatës kushtetuese 469
përbërjes politike 140, 414, 505
përbindësha të vërtetë kushtetues 655
per constittutionem 525
per constitutionem 105, 468, 500, 501, 508
përfaqësimi x, 43, 113, 220, 280, 282, 286, 299, 318, 347, 417, 442, 444, 460, 464, 474, 475, 486, 491, 529, 563, 568, 575, 606, 710, 711, 740, 745, 812
përfaqësimit të unitetit të popullit 475, 482, 495
Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm xix, 67, 72, 554, 555
përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë 529
përfaqësues komunal të UNMIK 760
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm 434
përfundon 118, 126, 315, 406, 436, 447, 449, 452, 458, 466, 471, 497, 498, 499, 502, 503, 540, 546, 560, 561, 562, 563, 565, 567, 569, 624, 698, 707, 771, 772, 803, 822, 825, 830
përgjegjësia disiplinore 420, 624, 669
përgjegjësia e presidentit të republikës 469
përgjegjësi disiplinore 420, 560, 562, 563, 565, 624
përgjegjësitë e Shtetit 278
përkohshme ix, 24, 43, 51, 60, 61, 62, 69, 70, 75, 103, 195, 200, 238, 247, 249, 290, 385, 425, 496, 499, 505, 507, 537, 545, 547, 554, 555, 571, 573, 588, 590, 597, 598, 599, 602, 617, 618, 619, 622, 631, 634, 645, 673, 674, 675, 679, 697, 724, 751, 758, 862
permanenca 212
Permanenca e funksionit gjyqësor 547
permanente 143, 203, 371, 385, 412, 425, 426, 632, 637, 643, 818, 820
përmbajtja e pushtetit 392
përshtatin sjelljet e tyre 620
personat juridikë 182, 239, 250, 282, 721
Peticioni 91, 372, 757, 819
petitumit 189

Petri i Dytë Karagjorgjeviq 50
Petri i Parë 47
pezullohet nga detyra 560, 562, 563, 565
Pierr Gulliam Imperiali 320
Pika e parë 521
Pikat dy dhe tre 523
Pinoçetit 405
Pirineje 684, 715
pjesa normative 136, 137
pjesët e veçanta 429
Plani Ahtisari 47, 68, 71, 74, 597, 599, 601, 776, 830
Planin Ahtisari 71, 74, 127, 128, 597, 599, 720
Planin strategjik për decentralizimin 761
Planit Ahtisari 24, 71, 74, 75, 103, 158, 596, 597, 600, 601, 602, 617, 674, 761, 776, 829, 830
Platoni 398, 399
Playmouth 398
plebishit 372, 374
plebishiti popullor 796
plurinominale 315, 316
Plymouth 398, 668
Podgorica 78, 113, 285, 317, 358, 359, 361, 396, 593, 806, 807, 809, 835, 837, 839, 840, 842, 864
Polibin 399
policia xi, 213, 418, 636, 641, 642, 643, 644, 648, 650, 651, 675, 691, 708, 718
Policia e përgjithshme 643
Policia e Republikës së Kosovës 646
policia politike 643
policia qendrore 643
policinë 336, 525, 641, 643, 648, 650, 653, 706, 734
policinë administrative 641
Policinë e Kosovës 473
policinë gjyqësore 641
Policinë lokale 643
policisë politike 643
Policisë së Kosovës 74, 438, 646
polici speciale 643
polipatridët 217
polis 641
politeia 147, 162, 641
politik 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 40, 42, 46, 47, 50, 51, 52, 54, 56, 60, 62, 63, 64, 68, 69, 71, 73, 74, 76, 77, 79, 82, 84, 85, 87, 91, 92, 93, 97, 114, 119, 122, 124, 125, 127, 130, 132, 134, 137, 138, 143, 144, 145, 147, 148, 149, 150, 151, 153, 154, 155, 157, 159, 160, 161, 162, 168, 169, 171, 172, 177, 178, 181, 183, 185, 186, 189, 190, 192, 197, 202, 203, 204, 205, 206, 207, 208, 209, 214, 217, 219, 220, 224, 228, 232, 242, 245, 247, 256, 258, 263, 277, 291, 299, 302, 304, 310, 311, 312, 313, 314, 316, 317, 318, 322, 323, 325, 326, 328, 331, 332, 337, 339, 340, 345, 346, 350, 358, 360, 364, 365, 372, 377, 381, 382, 383, 384, 386, 391, 392, 394, 395, 396, 398, 399, 401, 403, 405, 406, 407, 410, 411, 413, 414, 416, 421, 423, 424, 426, 430, 441, 442, 446, 463, 464, 467, 470, 471, 473, 474, 475, 480, 485, 486, 489, 492, 495, 504, 505, 506, 508, 509, 511, 512, 513, 515, 516, 519, 520, 521, 522, 524, 526, 528, 534, 535, 536, 539, 540, 542, 544, 546, 547, 548, 557, 566, 568, 571, 578, 581, 582, 584, 588, 591, 595, 604, 609, 610, 611, 628, 629, 637, 638, 640, 643, 651, 653, 654, 655, 656, 657, 660, 661, 668, 670, 672, 679, 681, 684, 688, 689, 691, 694, 696, 704, 705, 710, 713, 715, 716, 718, 719, 720, 724, 725, 726, 728, 730, 733, 737, 738, 742, 745, 747, 749, 750, 753, 755, 761, 768, 770, 790, 792, 794, 806, 807, 808, 815, 827, 828, 829, 838
Politika si profesion 391
politike vi, ix, 24, 26, 27, 28, 29, 30, 33, 35, 36, 37, 39, 42, 43, 44, 45, 51, 52, 53, 54, 56, 58, 61, 62, 65, 68, 69, 70, 71, 72, 73, 77, 78, 80, 84, 85, 87, 90, 91, 92, 93, 94, 96, 97, 102, 105, 109, 110, 111, 112, 113, 114, 118, 119, 120, 122, 123, 124, 125, 130, 132, 134, 135, 137, 138, 140, 142, 143, 145, 146, 147, 148, 149, 150, 151, 152, 153, 155, 157, 158, 160, 162, 167, 168, 169, 171, 172, 173, 174, 175, 176, 177, 178, 179, 180, 181, 182, 183, 184, 185, 189, 191, 193, 196, 197, 198, 204, 205, 206, 207, 208, 209, 211, 212, 217, 219, 220, 223, 225, 229, 237, 242, 243, 244, 245, 246, 247, 253, 256, 257, 258, 259, 260, 262, 263, 265, 267, 271, 274, 275, 276, 277, 279, 280, 281, 286, 287, 289, 291, 294, 297, 298, 299, 303, 305, 307, 308, 311, 312, 315, 316, 317, 318, 319, 320, 321, 322, 324, 325, 326, 327, 328, 329, 331, 332, 333, 334, 335, 339, 340, 342, 343, 344, 345, 346, 348, 349, 350, 351, 352, 354, 355, 356, 357, 358, 360, 365, 367, 368, 370, 372, 374, 376, 378, 380, 381, 382, 383, 384, 385, 386, 388, 392, 393, 394, 395, 396, 397, 398, 399, 400, 402, 403, 405, 406, 408, 409, 410, 411, 412, 413, 414, 416, 417, 418, 419, 421, 422, 424, 425, 427, 432, 435, 441, 442, 443, 445, 446, 452, 453, 456, 462, 463, 466, 467, 468, 469, 470, 471, 473, 474, 475, 476, 481, 486, 489, 491, 492, 493, 495, 500, 501, 502, 503, 504, 505, 506, 507, 508, 510, 511, 512, 513, 515, 519, 520, 523, 524, 525, 527, 528, 529, 531, 532, 533, 534, 542, 543, 545, 546, 548, 554, 555, 560, 561, 562, 563, 564, 565, 566, 567, 568, 573, 574, 577, 578, 582, 585, 586, 587, 588, 591, 594, 595, 596, 603, 604, 606, 607, 608, 609, 610, 611, 618, 623, 625, 626, 627, 628, 629, 630, 632, 633, 634, 637, 638, 640, 641, 642, 643, 644, 648, 653, 654, 655, 656, 657, 658, 659, 661, 662, 664, 668, 671, 674, 676, 679, 680, 681, 682, 683, 684, 685, 686, 688, 689, 690, 691, 692, 693, 694, 695, 696, 697, 698, 701, 702, 703,

704, 705, 709, 712, 713, 714, 715, 716, 717, 719, 722, 724, 725, 726, 727, 729, 730, 731, 732, 733, 734, 735, 736, 738, 739, 740, 741, 742, 743, 747, 751, 752, 755, 756, 761, 782, 788, 790, 792, 793, 794, 799, 807, 812, 813, 814, 819, 824, 826, 827, 828, 829, 830, 833, 848, 865, 907, 908
politikëbërjes 530, 654, 656
politikisht 34, 90, 92, 122, 144, 148, 204, 304, 308, 312, 370, 381, 383, 411, 412, 413, 417, 424, 463, 464, 469, 504, 505, 508, 510, 519, 522, 524, 532, 637, 646, 671, 717, 742
politologët 27, 381, 400
Polonia 25, 38, 218, 312, 319, 428, 467, 585, 606, 689
popullsinë autoktone 727
porotës 172, 549
Portorikon 701
Portugalia 38, 65, 418, 467, 471, 547, 601, 606, 716, 729
postulatet e parlamentarizmit britanik 583
pouvoir constituant 34, 35, 36, 51, 96, 128, 154, 853, 854
pouvoir constituant dérivé 35
pouvoir constitué 616
pouvoir constituiant originaire 128, 440
pouvoir neutre 655
pozita e qeverisë 422, 505, 711
pozita e tij juridiko-kushtetuese 462
pozitën e ministrave të qeverisë 505
pozitë të garantuar kushtetuese 658
pozitiviste-juridike 543
pozitivizmin gjerman 90
pozitivizmit 115, 149, 168, 582, 673
praeambulum 136
praeter constitutionem 92
pragu natyror zgjedhor 319, 387
pragun zgjedhor natyror 332, 435
pragu zgjedhor 311, 319, 328, 332, 350, 360, 361, 365, 387, 441, 442, 670
Praktika gjyqësore 110
pranueshmëria 626
Preambula 76, 136, 137, 141, 229, 231, 283, 284, 293, 294
prerogativat jo tradicionale 671
prerogativat jotradicionale 468
prerogativat tradicionale 468, 671
presidencial ix, 133, 146, 397, 408, 409, 411, 413, 431, 462, 464, 465, 466, 467, 469, 470, 482, 496, 498, 499, 504, 505, 539, 668, 669, 671
Presidente e Kosovës 473
Presidenti i Republikës 104, 139, 140, 336, 338, 354, 450, 451, 470, 474, 475, 476, 477, 478, 479, 480, 481, 482, 483, 485, 486, 487, 488, 489, 490, 491, 492, 493, 494, 495, 498, 499, 500, 501, 502, 503, 513, 520, 527, 528, 529, 536, 537, 538, 540, 541, 556, 558, 559, 565, 586, 600, 602, 603, 604, 608, 612, 615, 616, 619, 623, 635, 644, 645, 646, 647, 648, 649, 650, 663, 664, 670, 671, 672, 793, 813, 859
Presidenti i Republikës së Kosovës 104, 139, 336, 450, 451, 476, 477, 481, 489, 556, 558, 602, 603, 608, 612, 615, 616, 644, 645, 663, 670, 859
Presidentin e Republikës së Kosovës 443
Presidentit Ruzvelt 584
presidentit të Kosovës 492, 600
Presidentit të Republikës 31, 280, 364, 366, 368, 437, 443, 446, 450, 451, 452, 454, 456, 466, 473, 474, 475, 476, 478, 479, 480, 481, 482, 483, 484, 485, 486, 487, 488, 489, 490, 491, 492, 493, 494, 495, 496, 497, 498, 499, 500, 501, 503, 504, 505, 520, 526, 527, 528, 529, 535, 536, 537, 559, 561, 568, 588, 612, 615, 626, 628, 648, 649, 650, 652, 663, 665, 667, 671, 672, 806, 816, 859, 860, 863
Presidentit të SHBA-së 411, 426
president të Kosovës 473, 483
Presidiumit të Kuvendit Popullor të Serbisë 733
pretorianizëm 638
preventive 191, 193, 207, 245, 432, 474, 801
Prezumimi i kompetencës 685
prezumimi i vlefshmërisë 684
prezumimin e pafajësisë 87, 173, 202
prima facie 203
primogjenitura 464
Principatën e Serbisë 81
Principatës së Bullgarisë 76
Principatës së Malit të Zi 79
Prishtinës 4, xv, 27, 34, 71, 80, 331, 407, 588, 758, 768, 830, 835, 838, 907, 908, 909, 911, 913
privatësia 169, 191, 201, 243
privilegjet 25, 97, 167, 483, 607, 618, 674
Prizreni 281, 788
procedurale x, 79, 83, 87, 88, 89, 94, 95, 105, 121, 131, 159, 189, 204, 205, 236, 240, 241, 252, 281, 301, 302, 366, 385, 436, 484, 487, 488, 497, 529, 534, 544, 548, 549, 550, 622, 624, 625, 630, 649, 672, 675
procedurave standarde 202
procedurë gjyqësore 101, 187, 204, 241, 549, 583, 817
procedurën 30, 81, 95, 96, 100, 101, 110, 117, 120, 121, 122, 123, 124, 125, 126, 130, 131, 132, 135, 154, 161, 162, 186, 188, 189, 194, 201, 204, 233, 241, 258, 277, 288, 292, 308, 312, 314, 317, 321, 323, 329, 330, 340, 344, 362, 363, 364, 366, 367, 368, 371, 379, 416, 420, 421, 427, 428, 430, 445, 448, 461, 465, 468, 470, 482, 487, 489, 496, 499, 500, 510, 514, 520, 527, 531, 534, 536, 541, 542, 546, 557, 564, 565, 569, 571, 573, 574, 575, 577, 578, 581, 583, 586, 587, 590, 600, 609, 613, 620, 626, 627, 629, 630, 634, 635, 641, 703, 710,

719, 728, 729, 741, 766, 773, 783, 785, 787, 799, 811, 812, 813, 817, 818, 821, 823, 826, 862, 907
Profesionalizmi 637
profesionalizmi i kandidatit 546
profesorëve universitarë 605
programin e qeverisë 508
Prohor Pcinjski 76
Prokuroria e Posaçme 563, 564
Prokuroria Publike 552, 567, 572
Prokuroria supreme publike 575
Prokurori i Përgjithshëm 453, 563, 565
pronësinë 38, 263, 514
propozimi i ligjit 427, 448
propozimit të ligjit 425, 462
proselitizëm 184
Protokollin e Londrës 40, 155
provincë 116, 696, 715
prozelitizmi 198
Prusi 637
publicitetin e gjykimit 203
puna e detyrueshme 193, 213, 263
punimeve vjetore 446
punohet 424
pushtet 23, 25, 33, 34, 35, 36, 43, 48, 51, 53, 70, 109, 110, 119, 121, 128, 134, 141, 143, 144, 145, 150, 151, 154, 155, 161, 168, 173, 178, 184, 204, 208, 209, 217, 318, 325, 331, 354, 357, 373, 374, 378, 383, 384, 392, 393, 394, 395, 396, 397, 398, 400, 401, 402, 403, 404, 408, 411, 412, 416, 421, 425, 433, 442, 462, 463, 464, 468, 471, 504, 505, 507, 508, 509, 510, 517, 528, 579, 584, 591, 593, 606, 630, 644, 655, 657, 658, 659, 660, 661, 662, 663, 667, 668, 671, 676, 680, 684, 686, 702, 704, 706, 707, 712, 715, 730, 735, 740, 741, 790
pushtet amendamentues 35
pushtete politike 397, 400
pushteti 25, 26, 33, 34, 35, 36, 43, 44, 52, 60, 76, 78, 79, 80, 82, 84, 85, 86, 99, 113, 118, 119, 121, 125, 128, 132, 133, 143, 144, 145, 146, 147, 148, 149, 150, 151, 152, 154, 162, 167, 168, 170, 173, 179, 187, 206, 297, 303, 304, 307, 365, 372, 373, 384, 391, 392, 393, 396, 397, 399, 400, 401, 402, 403, 404, 405, 406, 409, 411, 412, 413, 422, 423, 431, 432, 437, 440, 462, 463, 465, 466, 468, 470, 476, 504, 510, 513, 514, 521, 535, 542, 543, 544, 554, 578, 582, 584, 585, 586, 604, 629, 637, 643, 655, 656, 657, 658, 659, 667, 668, 669, 672, 679, 681, 683, 684, 685, 686, 687, 688, 695, 698, 703, 704, 706, 707, 710, 711, 713, 716, 717, 718, 719, 724, 725, 727, 729, 730, 734, 735, 736, 743, 745, 746, 748, 749, 750, 751, 763, 790, 793, 794, 795, 799, 818, 821, 823, 824, 828, 829
pushteti burokratik 392
Pushteti ekzekutiv 403, 409, 686, 707
pushteti ekzekutiv-administrativ 405
pushteti ekzekutiv bicefal 411, 668, 672
pushteti ekzekutiv-politik 405
pushteti gjyqësor 150, 393, 397, 400, 401, 402, 409, 411, 413, 543, 544, 585, 684, 687, 711, 718
pushtet i katërt pa kokë 655
pushteti konstituiv derivativ 119
pushteti konstituiv origjiner 33, 34, 35, 36, 119
pushtetin burokratik 392
pushtetin ekzekutiv bicefal 504
pushtetin ekzekutiv të federatës 710
pushtetin gjyqësor 88, 142, 544, 559, 566, 568, 620, 687, 718, 806
Pushtetin real ekzekutiv 468
pushteti pasiv 463
pushteti qendror federal 76
pushteti shtetëror 25, 36, 84, 86, 143, 145, 149, 150, 173, 187, 391, 392, 393, 396, 657, 659, 667, 687, 818
pushteti specifik 656
pushtetit v, ix, x, xi, xii, xiii, 25, 26, 29, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 50, 52, 60, 62, 63, 66, 69, 70, 73, 77, 78, 79, 81, 82, 83, 84, 85, 87, 91, 92, 95, 96, 98, 99, 100, 103, 104, 106, 108, 110, 111, 112, 113, 114, 115, 116, 117, 118, 119, 120, 121, 122, 123, 124, 125, 127, 128, 129, 130, 131, 132, 133, 134, 138, 139, 140, 141, 142, 143, 144, 145, 146, 147, 148, 149, 150, 151, 152, 153, 155, 158, 159, 160, 161, 162, 168, 169, 170, 171, 172, 173, 176, 177, 178, 181, 188, 190, 193, 195, 197, 200, 201, 203, 204, 205, 206, 207, 214, 217, 220, 222, 225, 227, 228, 229, 230, 231, 232, 233, 241, 245, 246, 248, 250, 251, 266, 269, 270, 272, 280, 282, 283, 284, 285, 286, 287, 291, 293, 297, 298, 299, 300, 303, 304, 317, 321, 323, 325, 326, 329, 334, 351, 365, 366, 370, 371, 372, 373, 374, 375, 380, 381, 382, 384, 391, 392, 393, 394, 395, 396, 397, 398, 399, 400, 401, 402, 403, 404, 405, 406, 408, 409, 410, 411, 412, 413, 414, 415, 416, 417, 418, 419, 420, 421, 423, 424, 427, 428, 430, 431, 434, 438, 439, 440, 441, 442, 443, 445, 453, 455, 457, 460, 461, 462, 463, 464, 466, 467, 468, 469, 470, 471, 472, 476, 479, 495, 496, 499, 501, 502, 504, 505, 506, 509, 510, 511, 513, 514, 515, 516, 517, 519, 521, 522, 523, 532, 537, 539, 540, 542, 543, 544, 545, 546, 547, 550, 552, 554, 561, 567, 569, 578, 579, 582, 584, 587, 590, 593, 595, 616, 618, 620, 625, 626, 628, 629, 634, 638, 639, 640, 642, 643, 649, 651, 653, 654, 655, 656, 657, 658, 659, 660, 661, 663, 665, 666, 667, 668, 669, 671, 672, 675, 679, 680, 681, 683, 684, 685, 686, 687, 688, 689, 691, 692, 693, 694, 696, 702, 703, 704, 706, 707, 709, 710, 711, 713, 714, 715, 716, 717, 718, 719, 720, 723, 724, 725, 726, 728, 729, 730, 733, 734, 740, 741, 742, 743, 744, 745, 746, 747, 748, 749, 750, 751,

752, 753, 754, 755, 757, 758, 760, 761, 763, 765, 766, 767, 775, 777, 778, 779, 780, 781, 782, 786, 789, 790, 791, 792, 793, 794, 795, 796, 797, 798, 801, 805, 806, 807, 808, 809, 815, 817, 818, 819, 821, 823, 824, 825, 826, 827, 828, 829, 830, 865
pushtetit gjyqësor x, 63, 401, 411, 542, 543, 544, 545, 546, 547, 550, 552, 561, 567, 579, 584, 595, 687, 707, 710, 717, 718
pushtetit joqendror të ndërmjetëm 686
pushtetit origjinal kushtetutëbërës 440
pushtetit politik 37, 40, 60, 85, 87, 144, 149, 150, 159, 162, 168, 394, 395, 416, 506, 542, 691, 725, 808
pushtet konstituiv 33, 34, 35, 36, 119, 128, 154, 161, 442, 712
pushtet konstituiv derivativ 35
pushtet legal 151
pushtetndarjen e gjithanshme 128, 439, 440
pushtet neutral dhe i ndërmjetëm 403, 404, 471, 671
pushtet shtetëror 144, 392, 393, 394, 396, 463, 655, 660, 668, 676, 702
pyetje e kualifikuar parlamentare 422
Pyetje parlamentare 422, 457
pyetjet parlamentare 422, 443, 511

Q

qarku 310, 345, 347, 746, 792, 796, 819
Qemajl Kurtishi 764, 765, 788, 858
Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve 333
Qeska 477, 859
qeveria 47, 51, 58, 82, 86, 92, 115, 172, 355, 375, 384, 396, 398, 402, 406, 411, 412, 413, 420, 421, 422, 423, 426, 428, 432, 462, 467, 469, 483, 485, 504, 505, 506, 507, 508, 509, 510, 511, 512, 513, 514, 515, 516, 517, 518, 519, 520, 521, 522, 523, 524, 525, 526, 527, 528, 529, 530, 532, 533, 534, 535, 536, 537, 538, 540, 542, 581, 582, 594, 604, 610, 646, 650, 652, 668, 669, 672, 701, 705, 717, 733, 741, 743, 747, 748, 750, 763, 776, 779, 781, 782, 787, 789, 805, 806, 813, 821
Qeveria anarkike 506
Qeveria aristokratike 506
Qeveria e Durrësit 44
Qeveria e kabinetit 506
Qeveria e koalicionit 505
Qeveria e koncentruar 505
Qeveria e Kosovës x, 104, 512
Qeveria e Malit të Zi x, xix, 114, 539
Qeveria e Maqedonisë Veriore xix, 797
Qeveria e Vlorës 790
qeveria i legjitimon dhe i legalizon në formë të ligjeve propozimet e saj për politika publike 517
qeveria kancelarike 508
qeveria kleptokratike 507
qeveria kukull 507
qeveria/kushtetuta e përzier 398, 668
qeveria marionetë 507
qeveria në ekzil 507
qeveria parlamentare 505, 508, 514
Qeveria plutokratike 506
qeverinë e pakicës 505
qeverinë njëpartiake 505
qeverinë si aspekt politik i ekzekutivit 401
Qeverisë së Vlorës 42
qeverisja lokale 742, 752, 755, 762, 763, 829
qeverisjes së përzier 398, 399, 668
qeveritë despotike 506
Qipro 440
Qyteti i Beogradit 366, 367
qytetin e Beogradit 818

R / Rr

Raguza 463
raison d'etre 580
Rajhun Gjerman 693
Rajna e Veriut-Vestaflia 709
Rambuje 59, 60, 61, 62, 64, 156
Rankoviqit 735, 739
raporteve 443, 448
Raporti i Kai Eide 68
raport vjetor 175, 568, 662, 664, 666, 784
Rasti Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë 765
ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare 450, 461
ratione loci 477
ratione materiae 477
ratione personae 477
ratione temporis 477
Ratko 80, 115, 116, 158, 379, 739, 841
Ratko Markovic 158
Ratko Markoviq 80, 115, 116, 379
Reçakut 59, 156
referendum viii, 31, 63, 77, 81, 95, 106, 125, 131, 135, 157, 173, 205, 222, 231, 298, 357, 372, 373, 374, 375, 376, 377, 378, 379, 380, 381, 387, 406, 420, 421, 423, 429, 457, 462, 483, 626, 649, 681, 729, 738, 740, 743, 747, 754, 756, 785, 786, 796, 799, 804, 813, 818, 843, 846
referendume abrogative 373
referendume konstitutive 373
Referendumi ix, 77, 80, 125, 140, 372, 376, 377, 378, 380, 381, 462, 747, 794, 796
referendumi i mëpastajmë 373
referendumin lokal 742, 819
referendumin në nivel qarku 796

referendumi paraprak 373
referendumi për pavarësinë 325
referendumit 30, 77, 80, 95, 125, 126, 130, 131, 134, 161, 222, 227, 325, 364, 371, 372, 373, 374, 375, 377, 378, 379, 380, 423, 433, 450, 457, 458, 459, 462, 468, 482, 586, 587, 626, 670, 681, 685, 712, 728, 740, 762, 796, 822
referendumit kushtetues 134, 161
referendum kushtetues 374, 796
referendum ligjor 374
referendum vendor 796
regjenca 433, 467
regjencës 464
regjimin juridik të kontrollit 685, 824
regjimit republikan 51
regjion 371, 372, 397, 686, 714, 715, 716, 717, 718, 719, 723, 727, 733, 734, 739, 746, 826
regjionale xi, xii, xvii, 65, 66, 80, 146, 172, 176, 219, 220, 230, 231, 247, 249, 308, 314, 315, 381, 395, 586, 680, 684, 685, 686, 687, 712, 713, 714, 716, 717, 718, 719, 720, 722, 724, 725, 729, 802, 826
regjionalizëm asimetrik 723
regjionalizëm politik 728, 827
regjionalizimin 737
regjionit politik 720
regjistër qendror civil 333
regjistra të veçantë zgjedhor nëpër njësi zgjedhore 311
regjistri qendror civil 333
relative 94, 95, 163, 192, 243, 282, 317, 318, 326, 328, 331, 350, 426, 429, 435, 464, 505, 699
religjionit grek ortodoks 41, 155
rendet fetare 299
rendit publik 174, 186, 196, 197, 199, 209, 569, 641, 642, 643
rend kushtetues 23, 152, 153, 192
Rene Dekart 147
republika 45, 56, 57, 75, 146, 426, 464, 694, 696, 698, 715, 738, 839
Republika a Kosovës 763
Republika Bataviane 688
Republika e Kosovës 221, 242, 270, 274, 275, 278, 279, 281, 496, 616, 622, 644, 736, 781, 782
Republika e Serbisë 56, 287, 380, 461, 592, 722, 734, 755, 762, 778, 819
Republika e Shqipërisë 108, 224, 225, 253, 341, 625, 866
Republika Federale e Jugosllavisë xix, 325, 364, 629, 682
Republikën Çeke 419
Republikën e Dytë 98
republikë parlamentare 29, 44, 224, 470, 513, 515, 517
reservatio legis 230
res interpretata 620
res judicata 195, 543, 620
restitutio in integrum 188
revolucion 123, 151, 416, 504, 700
revolucionet amerikane dhe franceze 37
Revolucioni i lavdishëm anglez 37
Revolucionin Amerikan 417
Revolucionin e Tetorit 173
Revolucionin Francez 40, 415
revolucionit 25, 40, 83, 118, 158, 172, 213, 288, 416, 418, 550
Revolucionit Francez 40, 42, 118, 168, 416, 419, 513
Revolucionit Madhërishëm 415
Revolucionit të 44, 171, 381, 463, 504
Revolucionit të Madhërishëm 381, 504
Revolucionit të Tetorit 44, 171
revolucion pa fije gjaku 504
rezervate kushtetuese 96
rezoluta 68, 69, 421, 443, 456, 458
Rezoluta 1244 46, 62, 68, 69, 70, 80, 81, 157, 158, 554, 596, 760
Rezoluta mbi themelimin e Këshillit Anitifashist të Çlirimit Kombëtar të Jugosllavisë 50
Rezolutën 1244 61, 69, 70, 71, 73, 74, 75, 127, 554, 596, 597, 760
Rezolutën për Pavarësi dhe Sovranitet 325
Rezolutës 1244 61, 65, 68, 69, 70, 73, 74, 157, 158, 597, 760
Ribentrop-Molotov 507
riforcojnë demokracinë 658
Rihard Kalegri 691
Riksdag 414
rishikim i tërësishëm 120
rishikimit të pjesshëm 96, 159
rishikimit total 96, 159
Robert Mishels 384
Rodezia e Jugut 392
Rohinga 198
rol konsultativ 719
Romë 109, 147, 167, 317, 718
rregullat e tij brendshme 427
rregullat mbi rregullimin e shtetit 29
rregullat zgjedhore 301, 329, 385
rregullimi shtetëror federal 681
rregullim monarkik 84, 752
rregulloreve autonome 511
rreth autonom 52
rretheve 315, 318, 680, 704, 733
Rudolf Jering 427
Rumania 130, 433, 585, 606
Rusia 42, 57, 62, 138, 206, 212, 319, 322, 418, 428, 433, 465, 467, 587, 606, 679, 682, 689, 690, 699
Rusia Cariste 57

Ruso 28, 147, 167, 398, 399, 400, 679, 694

S / Sh

Saharaja Perëndimore 299
Sainte-Lague 328, 343, 435
salamander 316
Sami Frashëri 39, 790, 830, 841
San Francisko 57
San Marino 37, 858
Sardinia 714, 723
seanca plenare 416, 424, 426
seanca të jashtëzakonshme 446
seanca të përbashkëta 426
seanca të rregullta 446
Seancës së Përgjithshme 571, 574
secundum constitutionem 92
sekretarin e komunës 814
sekretarit të kuvendit 814, 815, 821
Senat 307, 373, 410, 411, 482, 714, 715
Senati i Kongresit 709, 710
senatin e kontesteve kushtetuese 585
senatin e të drejtave themelore 585
Seneka 179
seniors 506
Serbia xii, xiii, 43, 45, 53, 54, 55, 56, 58, 59, 61, 74, 75, 79, 80, 81, 106, 113, 131, 135, 156, 158, 265, 268, 324, 325, 358, 359, 365, 433, 467, 469, 552, 553, 591, 592, 593, 629, 632, 636, 667, 682, 694, 696, 700, 720, 721, 722, 725, 726, 729, 735, 736, 739, 752, 782, 817, 828, 837, 845, 847, 860, 862
Serbia dhe Mali i Zi 79, 81, 324, 682, 752
Serbia e Millosheviqit 59, 156
sesione të jashtëzakonshme 459
sesione të rregullta 459, 461
sferave të interesit 45
sferën e mbrojtjes dhe sigurisë së shtetit 424
Sharl de Gol 372, 374
SHBA xvii, xix, 28, 33, 37, 44, 49, 62, 80, 83, 93, 96, 98, 113, 124, 125, 126, 132, 136, 138, 147, 158, 160, 161, 171, 177, 183, 185, 192, 194, 197, 198, 200, 219, 299, 303, 304, 305, 306, 307, 310, 313, 314, 316, 317, 322, 323, 372, 373, 381, 383, 387, 397, 400, 408, 409, 410, 411, 418, 420, 423, 424, 426, 427, 428, 430, 464, 465, 466, 467, 468, 469, 470, 471, 482, 489, 492, 495, 546, 547, 548, 579, 584, 586, 601, 610, 636, 653, 671, 679, 681, 682, 693, 694, 695, 696, 697, 698, 699, 701, 702, 703, 709, 711, 727, 737, 745, 746, 790, 825, 835, 836, 838, 908
Shefi i shtetit ix, 236, 428, 432, 462, 464, 468, 471
shef i qeverisë 466
shefit të misionit diplomatik 520
shefit të shtetit 76, 133, 146, 313, 319, 364, 386, 405, 409, 411, 412, 413, 414, 416, 417, 423, 426, 430, 444, 450, 463, 464, 466, 468, 470, 471, 472, 473, 474, 475, 480, 482, 483, 488, 494, 497, 498, 499, 501, 502, 503, 504, 512, 513, 539, 585, 587, 602, 607, 615, 638, 640, 655, 656, 671, 672, 710, 747
Shën Augustinit 167
shërben shkelja e rëndë e pohuar 497
shërbëtor 384, 463, 504
shërbime publike lokale 811
shërbimeve publike 146, 206, 239, 246, 250, 283, 519, 520, 740, 744, 745, 746, 757, 763, 775, 776, 779, 788, 789, 798, 808, 816
shërbimi civil 519, 535, 672, 760
shërbimi civil komunal 760
shërbimin informativ 650, 653
Shërbimin Informativ i Shtetit xix, 648
Sheriatit 39
shkarkim 138, 410, 423, 443, 459, 487, 490, 491, 497, 502, 503, 524, 525, 526, 533, 538, 541, 542, 567, 571, 572, 573, 576, 612, 632, 635, 665, 759, 773
shkarkimit të shefit të shtetit 587
shkarkohen 410, 444, 456, 489, 535, 556, 557, 558, 559, 565, 569, 570, 576, 612, 615, 632, 637, 646, 822
shkarkohen nga detyra 535, 559, 569, 632
shkelje serioze 410, 475, 497, 588
shkeljet e rënda 497
shkelje të rënda 497, 498, 560, 562, 563, 565, 625, 793
shkeljet serioze 497
shkencave politike 27, 739
shkëputje krejt radikale 65
shkëputje me të kaluarën 65
Shkup 78, 112, 326, 349, 738, 836, 841, 865, 866
shkurtohet 233, 418, 431, 436, 458, 509, 670
shmangiet nga liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të komuniteteve 234
Shmit-Kelsen 473, 485
shoqërisë civile 150, 298, 327, 395
shorti 348, 546
shpallja e xii, 48, 51, 70, 73, 131, 134, 148, 301, 314, 334, 379, 415, 426, 427, 444, 450, 458, 459, 468, 471, 479, 490, 581, 640, 652, 685, 724, 756, 822
Shpallja e ligjeve 450
shpalljes përfundimtare të rezultateve 418
shpalljes së referendumit 377, 423
shpall referendumin 379, 460, 467, 819
shpërndaj parlamentin 431, 433, 467, 512
shprehje e marrëdhënies hierarkike 750, 829
Shqipëria xii, 29, 39, 42, 44, 45, 50, 94, 106, 130, 135, 198, 223, 224, 225, 236, 237, 251, 257, 258, 283, 342, 343, 344, 345, 347, 387, 606, 628, 633,

724, 737, 790, 791, 840, 841
Shqipërinë londineze 42, 44, 155
shqyrtime publike 119, 126
Shqyrtimi i dytë i projektligjit 449
Shqyrtimi i parë i një projektligji 449
shqyrtimin e tretë 450
shqyrtimit dhe mbikëqyrjes administrative 786, 830
shqyrtim të parë 449
Shtërpcës 776
shtetas i Kosovës 492
shtetasit 144, 179, 180, 181, 217, 218, 223, 225, 226, 229, 253, 254, 261, 269, 274, 275, 276, 277, 289, 297, 303, 333, 347, 355, 560, 563, 639, 644, 684, 737
shtetas të konfederatës 692
shtete 23, 43, 49, 80, 91, 92, 95, 97, 119, 131, 135, 139, 143, 144, 145, 146, 147, 151, 160, 163, 172, 179, 183, 184, 190, 192, 199, 201, 212, 297, 299, 304, 310, 313, 316, 322, 324, 325, 370, 372, 386, 392, 395, 405, 409, 411, 440, 506, 547, 580, 583, 612, 629, 633, 658, 674, 680, 682, 686, 687, 689, 692, 694, 695, 697, 698, 699, 700, 701, 702, 704, 705, 706, 711, 712, 714, 715, 717, 726, 727, 728, 729, 745, 826
shtete afrikane 409
shtete rregullatore 395
Shtetësia 59, 61, 66, 74, 75, 95, 217, 218, 223, 225, 230, 596, 760, 838
shtetësinë e shtetit 729
shtetet e përbëra 586
shtete të përbëra 145
Shtetet e thjeshta 146
shtete të thjeshta/unitare 145
shtetet federale 145, 704, 725, 825
shtetet nën kujdestari 146
shtetet nën mandat 146
shtetet nën protektorat 146
shtetet vasale 146, 393
shtete unitare 144, 680, 686, 687, 704, 727
shteteve borgjeze 168
shteteve të përbëra 145
shtet federal 48, 94, 465, 586, 629, 693, 697, 724, 733
shteti absolut 86, 683
shtet i decentralizuar 725
shteti intervencionist 394, 395, 668
shteti intervencionist? 668
Shteti i përbërë xi, 145, 688
shteti i së drejtës 149, 394, 542, 581
shteti-komb 694
shtet i lidhur 694
shteti menaxherial 395
shteti minimal 668
shtetin e përbërë 681
shtetin e përfitimeve 394
shtetin e shërbimit 394
shtetin operator 395
shtetin policor 394
shtetin prodhues 395
shtetin rregullativ 394
shtetin social 210, 394
Shteti policor 510
shtetit absolut 37, 86
shtetit bashkëkohor të mirëqenies 744, 829
shteti territorial 683
shtetit intervencionist 403, 404
shtetit kushtetues 37
shtetit policor 657
shtetit social 210, 211, 248, 394, 661
Shtetit të Kosovës 139, 554, 720, 723, 724, 763, 767
Shteti Virgjinia 37
shtet laik 199, 242, 681
shtet minimal 394, 790
shtet qytetar 30, 228, 230, 231, 285
shtet regjional 586, 715, 723
shtet social 89, 248, 292
shtet të mirëqenies ekonomike dhe prosperitetit social 248
shtet unitar i decentralizuar 725
shumica absolute 318, 378, 429, 452, 815
shumica e thjeshtë 426, 429
shumica parlamentare 110, 319, 384, 411, 421, 424, 427, 505, 507, 508, 509, 511, 512, 517, 638
shumicë absolute 103, 111, 126, 135, 318, 350, 426, 444, 465, 528, 606, 699, 712
shumicë e kualifikuar 429, 604, 615
shumicën e votave 234, 281, 358, 369, 378, 380, 443, 444, 446, 450, 454, 455, 456, 457, 458, 459, 461, 481, 486, 500, 528, 538, 568, 570, 607, 627, 631, 635, 647, 662, 663, 670, 759, 800, 802, 803, 815, 821
shumicë të butë 374, 387
shumicë të kualifikuar 91, 95, 98, 135, 160, 426, 585
shumicë të rreptë 374, 387
shumicë të thjeshtë 48, 98, 135, 410, 426, 450
Shviz 697
Sies 416
siguri materiale 548
Silly Isles 683
simbolet 110, 113, 141, 142, 145, 222, 279, 281, 441, 450, 459, 729, 762, 767
simbolet shtetërore 110, 141, 142, 145, 281, 459
simetria e pjesshme nacionale 697
Simon Bolivar 689
Siria 137, 297, 639
sisteme të ndryshme të pushtetit 408, 505
sistemet e përziera 397, 406, 432, 462, 465, 468,

671
sistemet e përziera të pushtetit 397, 468
sistemet gjysmëpresidenciale 462
sistemet parlamentare të pushtetit 468
sistemi amerikan 466, 546
sistemi dypartiak 383
sistemi francez 411
sistemi gjysmëpresidencial 397, 466
sistemi i delegimit 326, 836
sistemi i kuvendeve 405, 462
sistemi i përzier 38, 366, 411
Sistemi i përzier i pushtetit 412, 668
sistemi i shumicës absolute 317
sistemi i shumicës relative 317
sistemi i Uestministerit 412
Sistemi joformal i vetëqeverisjes lokale 746
sistemi komunal 753, 797, 806
sistemi komunal i vetëqeverisjes 753, 797
sistemi kushtetues 23, 153, 178, 397, 519, 528, 632, 695
sistemin e centralizuar të vlerësimit të kushtetutshmërisë 583
sistemin e decentralizuar të vlerësimit të kushtetutshmërisë 583
sistemin e kapitulacioneve 737, 828
sistemin e kuvendeve 173, 431, 505, 593, 668, 730, 821
sistemin e njëllojtë 744, 829
sistemin e përzier 319, 387, 412, 413, 504, 505, 507, 549, 703
sistemin e përzier të porotës 549
sistemin e përzier zgjedhor 319, 387
sistemin e pushtetit 38, 147, 397
sistemin e të drejtës së përgjithshme 23, 88
sistemin klasik parlamentar 411, 462
sistemin kushtetues 23, 51, 53, 97, 98, 103, 108, 139, 178, 298, 472, 521, 534, 553, 589, 606, 637, 762, 798, 829
sistemin me shumë lloje 744, 829
sistemin parlamentar 384, 393, 397, 408, 411, 413, 431, 432, 504, 509, 669
sistemin parlamentar klasik monistik 432
Sistemin partiak 383
sistemin presidencial 397, 408, 411, 413, 431, 467, 504, 505
sistemin presidencial të pushtetit 467
sistemin zgjedhor proporcional 320, 326, 387, 417, 505, 668
sistem i përzier 408
Sistemi presidencial ix, 408
sistemit kryesisht mazhoritar zgjedhor 812
sistemit mentorial 547
sistemit parlamentar të përzier 412
sistemi tradicional anglez i vetëqeverisjes lokale 683
Sistemi treshkallësh 746
sistemit të komunave 753
Sistemi zviceran i kuvendeve 414
sistem mazhoritar 345, 366
sistem politik 23, 745
sistem proporcional 327, 342, 345, 366
sistem specifik të përzier 409
sistem zgjedhor proporcional 505
sistem zgjedhor të shumicës relative 505
Skanderbegas 39
Skocisë 681
Sllovaki 482, 585
Sllovenia 92, 325, 341, 358, 433, 467, 469, 606, 684, 694, 696, 746, 807, 864
sociologjik 29, 33, 35, 144, 145, 154
sociologjisë politike 739
socio-politike 90, 152, 220, 394, 395, 629, 668
sofistët grekë 167
Sovjetike xvii, 37, 38, 52, 132, 173, 211
sovranëve 504
sovraniteti xi, 36, 43, 62, 84, 113, 138, 141, 147, 150, 151, 205, 227, 229, 231, 303, 379, 404, 415, 443, 444, 511, 629, 642, 667, 701, 704, 705, 706
sovraniteti i brendshëm 706
sovraniteti i kombit 150
sovraniteti nacional 303
sovraniteti popullor 150, 205, 303, 404, 443, 511, 642, 704
sovranitetit dhe integritetit territorial 263, 444, 636, 644, 645
sovranitetit popullor 123, 134, 145, 302, 417, 506, 584, 642, 684
sovranitetit të brendshëm 391
sovranitetit të jashtëm 391
sovranitetit të kushtetutës 34
Spanja 38, 65, 96, 138, 319, 321, 418, 422, 425, 430, 508, 547, 548, 583, 585, 586, 587, 601, 606, 680, 684, 686, 713, 714, 716, 717, 719, 726, 728, 729, 730, 746, 826, 827
Spartës 179, 399, 654
Speaker 424
specializuar 189, 256, 305, 550, 636, 653, 656, 658, 660
sreze administrative 752
Srezet 752
Staatsrecht 84, 159
Stalini 50
stalinisto-komunist 753
Standardet para Statusit 67, 68, 157
standard procedural 95
stare decisis 100, 105, 190, 621
statusit juridiko-kushtetues 712, 716, 728, 825
statut 37, 99, 111, 114, 208, 381, 383, 385, 628, 676, 712, 717, 747, 748, 757, 759, 772, 773, 803, 810, 814, 815, 819, 820, 823, 848

Statutet e komunave 111, 766
Statuti Albertino i Italisë 134
Statuti i KAKM 754
Statuti i Lushnjës 44, 155
Statuti i Përkohshëm i Këshillit Ndërkombëtar të Kontrollit 43
Statutin e GJND-së 588
Statuti organik i Shqipërisë 134
Stortinget 414
Strasburg 88, 105, 112, 176, 223, 224, 253, 609, 633, 713, 865
strukturën bicefale 462
strukturën monocefale 462
sua sponte 590, 593, 594, 595, 603, 626, 630, 634, 635
subjekte të së drejtës ndërkombëtare 143, 692
subjektive 127, 178, 219, 289, 302, 402, 475, 533, 609
Suedi 26, 93, 321, 414, 636, 742
Suedia 30, 38, 133, 312, 508, 612, 639, 690, 716, 746
Suedinë 134, 637
sui generis 74, 109, 112, 602, 660, 816
suksesin e gjyqtarëve 547
Sulltan Abdylhamitin II 39
Sulltani 81
Sulltanit 39
summa potestas 144
sundimit të ligjit 128, 130, 149, 152, 172, 185, 222, 281, 473, 506, 543, 645
superiorem non recognoscens 396, 668
super-kushtetues 720, 826
suspendim 185, 186, 187, 773, 774
Svetomir Shkariq 108

T / Th

Tajvani 138
Tallejrand 83
tatimet lokale 750, 804
tatimi që i mbledh shteti 750
të drejta absolute njerëzore 202
të drejta politike 181, 184, 204, 208, 217, 289, 291, 727, 827
të drejtat e gjelbra 182
të drejta të koncesionit 275
të drejtat e kuqe 181
të drejtat e solidaritetit 181, 182
të drejta të statusit pozitiv 179, 289
të drejtën e vetos absolute 430
të drejtën në vendqëndrim 195, 290
të drejtën për referendum 63, 157
të drejtën për vendbanim 195, 290
të drejtës për vetëvendosje 185, 735
të gjithë janë të barabartë para gjyqit 544
Teknikat e votimit 427
teknikës zgjedhore 302, 385
tekniko-juridik 469, 543, 580
të mosbesimit 412, 422, 433, 451, 462, 507, 512, 534, 535, 537, 539, 540, 541, 669
të ndarë nga tri pushtetet klasike 655
teori katraliste 403
teoritë dualiste 400
Teoritë katraliste 403
teoritë trialiste 400, 401
të parimit të legalitetit 241
të përgjithshme 28, 63, 75, 83, 92, 93, 100, 107, 111, 113, 114, 115, 116, 119, 138, 140, 180, 189, 205, 227, 232, 234, 236, 255, 256, 259, 261, 271, 272, 273, 300, 314, 327, 334, 335, 341, 342, 345, 349, 352, 353, 360, 362, 364, 367, 399, 402, 404, 405, 407, 431, 435, 443, 455, 458, 460, 462, 464, 485, 500, 507, 530, 540, 550, 553, 560, 563, 570, 574, 575, 580, 581, 582, 586, 589, 590, 595, 608, 609, 611, 614, 629, 630, 632, 633, 634, 640, 671, 674, 707, 722, 728, 733, 734, 736, 740, 741, 743, 746, 747, 748, 751, 754, 792, 793, 794, 796, 800, 805, 808, 813, 815, 816, 817, 819, 821, 822, 828
të Përkohshme të Vetëqeverisjes 73
territoret nën kujdestari 143
territoret që nuk qeverisen vet 143
territorial 43, 47, 49, 62, 63, 69, 74, 77, 91, 102, 122, 138, 142, 146, 155, 197, 207, 218, 219, 222, 225, 229, 232, 233, 263, 342, 391, 395, 417, 444, 556, 557, 558, 616, 636, 644, 645, 650, 683, 688, 692, 712, 715, 716, 722, 723, 724, 729, 737, 740, 753, 760, 793, 802, 808, 812, 817, 824, 827, 845, 857, 908
territorin e shtetit 195, 196, 218, 303, 353, 444, 550, 649, 683, 686, 687, 717, 729
territori shtetëror 143, 162
tërthorazi 41, 98, 220, 274, 409, 415, 437, 511, 512, 587, 672, 719, 723
tetëmbëdhjetë 137, 253, 262, 488, 768, 801
të veçanta 104, 177, 178, 181, 219, 222, 241, 249, 255, 256, 259, 263, 272, 278, 279, 307, 310, 312, 317, 327, 329, 332, 337, 339, 340, 355, 366, 408, 417, 424, 425, 426, 431, 436, 442, 445, 449, 450, 451, 464, 465, 479, 493, 506, 518, 547, 559, 600, 601, 602, 671, 716, 727, 744, 752, 755, 762, 769, 788, 795, 801, 816, 818, 826
të zbatojnë vendimet 620, 764
Thiers, Adolphe 463
Titos 730, 735, 753
Tito Shubashic 46
Togo 137, 863
Toma Akuinin 399
Toma Akuinit 167
Tomas Hare 320
Tomas Hobes 679, 694

Tomas Hobs 150, 167, 169
Tomas Hobsi 147
Tomas Jeferson 123
Tomë Krasniqi vs RTK dhe KEK 588
Tory 381
traidike 659
trajnimit të veçantë 547
Traktatit të Londrës 44
transmetues të vullnetit të zgjedhësve të tyre 465
Trentino 714, 723
triadie 659
trias politica 393
Tribunalin Kushtetues të Portugalisë 703
Tribunal Superior de Justicia de Catalunya 718
triniteti klasik 403
Trinity House 653
trishkallëshe 410, 427
trupa të pazgjedhura 654
Trupat e përhershme parlamentare 425
Trupat e përkohshme parlamentare 425
Trupat punuese 424, 425
tubimet publike 297, 757
Turqia 57, 137, 217, 319, 467, 473, 606, 640

U

Uashingtonit 701
UÇK xix, 53, 58, 59, 62, 78, 105, 156, 272, 326, 594, 595, 720, 736, 738, 756, 797, 828
Udine 714
Udro Uilson 44
Uigët 381
Uilliami I i Anglisë 415
Uinston 148, 691
Uinston Çërqill 148
Ukraina 136, 473, 585, 606, 729
ulëset e rezervuara 328, 331, 435
ulëseve te garantuara 331
Ulpiani 86
ultra vires 498
UMZi 651
unconstitutional constitutional amendments 583
uninominale 315, 316
unionet reale 145, 690
unioneve reale 690, 697, 825
unioni doganor 690
unioni i bashkuar 681, 823
unioni monetar 690
Unionin e Utrehtit 689
unioni personal 690, 824
Unioni Poloni-Lituani 688
Unionit Arab Hashemit 694
unioni ushtarak 690
unitare 144, 145, 146, 680, 681, 683, 686, 687, 688, 693, 694, 704, 725, 727, 728, 729, 739, 827, 828
unitarizimi 687, 824
unitary authorities 683
unitet absolut të pushtetit 405
uniteti jodemokratik i pushtetit 405
uniteti relativ i pushtetit 405
unitetit juridik-kushtetues 484
unitetit juridiko-kushtetues 470, 471, 472, 493
unitet konkret juridiko-kushtetues 476
Universitetin e Prishtinës xv, 27, 907, 909, 911, 913
Universitetit të Parisit 83, 158
UNMIK x, xix, 47, 61, 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73, 74, 75, 129, 157, 326, 327, 329, 330, 434, 439, 551, 553, 554, 555, 556, 588, 596, 597, 670, 673, 756, 757, 758, 760, 761, 829, 862
UNMIK- xix
UNMIK-u 67, 68, 69, 70, 72, 73, 75, 157, 326, 327, 330, 439, 554, 555, 556, 588, 596, 597, 760
UNMIK-ut 61, 67, 68, 69, 70, 71, 74, 75, 157, 326, 327, 329, 434, 551, 553, 554, 555, 597, 670, 673, 756, 757, 758, 760, 761, 829, 862
Untervalden 697
urbi et orbi 80
urdhrave ekzekutivë 409
Ushtria Çlirimtare e Kosovës xix, 326
Ushtria Çlirimtare Kombëtare 78, 272
Uttar Pradesh 709

V

Vatikani 198, 299, 680, 684
Velsit 681
vendbanimin 195, 196, 201, 205, 236, 241, 274, 308, 311, 335, 355, 368, 465, 502, 768, 771, 801
vendime përfundimtare 107, 626
vendimit për masat e përkohshme 619
Venediku 463
Venezuela 38, 124
veprimtaria ekzekutivo-politike 406
Verfassungsgerichtshof 585
veriun e vendit 724
Versajë 44, 49, 218, 416
versioni liberal-demokratik i sundimit të së drejtës 149
versioni socialist i sundimit të së drejtës 149
vërtetuese 620
vertikale xi, 99, 396, 397, 519, 521, 535, 545, 672, 679, 680, 707, 715, 718, 720, 724, 741, 742, 823, 825
vetëgjyqësisë 406
vetëmenaxhim 722, 723, 737, 782, 828
vetëmenaxhim të plotë 737, 828
vetëm një nen normon punën e grupeve parlamentare dhe funksionimin e tyre 446

vetëqeverisja lokale 142, 146, 239, 250, 283, 511, 617, 716, 726, 728, 742, 744, 745, 748, 749, 750, 751, 752, 756, 791, 808, 809, 810, 811, 812, 817, 818, 827, 829, 830
vetëqeverisjes komunale 753, 754, 760, 767
vetëqeverisjes politike 220, 742
vetëqeverisje vendore 790, 795
vetinguit në drejtësi 566
vetingun shqiptar 140
Vetingu shqiptar 140
vetoja e xhepit 409, 430
vetoja popullore 371, 374, 387
vetos 54, 55, 103, 129, 412, 427, 430, 439, 440, 441, 448, 450, 467, 468, 481, 591, 592, 669, 693, 710, 745
vetos absolute 430, 669
veto suspenzive 430, 431
Viktor d'Hondt 321
Viktor Hugo 691
Virxhinia 168, 172, 288, 711
vis-à-vis 619
Vjenë 74, 596, 907, 908
Vlorës 42, 43, 44, 790
vocatio legis 431, 451
Vojvodina 50, 52, 55, 56, 552, 588, 592, 728, 733, 735
volonté générale 28
vota kumulative 312
votëbesim 412, 423, 451, 452, 541
votëbesimi x, 423, 534
votëbesimin 422, 423, 534, 541, 672
votëbesimin e qeverisë 422, 534
votëbesimit 423, 451, 459, 462, 512, 534, 541
votëbesim të qeverisë 451, 541
votën preferenciale me automatizëm 328
votës plurale 305, 306, 386
votës së bartshme 310
votimi alternativ 302
votimi i besimit të qeverisë 423, 669
votimi kumulativ 302, 310
Votimi mosbesimit 422
votimi mosbesimit të qeverisë? 669
Votimi mosbesimit të qeverisë 422
votim individual 310
votimin e mosbesimit 421, 423, 443, 469, 508, 509, 538
votimin konstruktiv i mosbesimit 507
votimi për mosbesimin e qeverisë 422
votimi plural 305
votimit familjar 306
votimit konstruktiv të mosbesimit të qeverisë 422, 669
votimit të mosbesimit 412, 433, 507, 512, 541
votimit të suksesshëm 428, 451
votohet mosbesimi 412, 451, 541
votuar mosbesimi 507, 538
vullnetin e përgjithshëm 28, 118, 399, 402
vullnetit të përgjithshëm 118, 173, 385, 407, 428, 583, 730

X / Xh

Xhandarmëria 643
Xhejms Brys 132, 135
Xhejms Madison 123
Xhejms Perdju 113
Xheremi Bentam 742
xherimandering 302, 316, 386
Xhon Harlan 584
Xhon Kalvin 398
Xhon Llok 150, 400
Xhorxh Jellinek 168, 178, 289
Xhorxh Vedel 35
Xinjiang 198

Z / Zh

zakonet juridike 114
zakonet ndërkombëtare 105, 107, 109, 221, 264
Zakoni kushtetues 91
zakonisht nuk është më i shkurtër se katër vjet 466
zbrazëtirë juridike 97
Zdravko Zlokapa 796, 842
Zelanda e Re 30, 154, 318, 508, 726
zgjedhje e kombinuar 709
zgjedhje e tërthorët 709
zgjedhje komunale 327
zgjedhjet vii, viii, 39, 51, 62, 73, 97, 99, 100, 104, 116, 204, 205, 217, 222, 225, 228, 231, 234, 235, 291, 297, 299, 300, 301, 302, 305, 306, 308, 310, 311, 312, 313, 314, 315, 316, 317, 319, 320, 321, 322, 323, 324, 326, 327, 328, 329, 330, 331, 332, 334, 335, 337, 338, 339, 340, 341, 342, 343, 344, 345, 346, 347, 348, 349, 350, 351, 352, 353, 354, 355, 356, 357, 358, 359, 361, 362, 364, 365, 366, 367, 368, 369, 370, 371, 372, 377, 382, 385, 386, 387, 418, 421, 423, 432, 434, 435, 436, 441, 450, 452, 453, 454, 456, 459, 462, 465, 466, 468, 469, 478, 479, 492, 496, 497, 499, 501, 503, 511, 527, 529, 541, 547, 550, 567, 570, 610, 617, 647, 649, 657, 670, 705, 714, 717, 731, 733, 762, 766, 768, 771, 786, 794, 799, 804, 812, 813, 819, 861, 865
zgjedhjet lokale 116, 217, 222, 308, 310, 329, 331, 332, 338, 339, 340, 349, 361, 364, 366, 367, 370, 387, 441, 450, 762, 766, 799, 804, 812, 813, 819, 865
zgjedhjet me listat të hapura 312
zgjedhore vi, vii, viii, 26, 100, 103, 111, 116, 119, 126, 150, 174, 178, 179, 180, 181, 189, 196, 204,

205, 206, 217, 223, 225, 244, 253, 254, 258, 262,
267, 268, 291, 293, 297, 298, 299, 300, 301, 302,
303, 304, 306, 308, 309, 310, 311, 312, 313, 314,
315, 316, 317, 318, 319, 320, 321, 322, 323, 324,
326, 327, 328, 329, 330, 331, 332, 333, 334, 335,
336, 338, 339, 340, 341, 342, 343, 344, 345, 346,
347, 348, 349, 350, 351, 352, 353, 354, 355, 356,
358, 359, 360, 361, 362, 363, 364, 365, 366, 367,
368, 369, 370, 372, 378, 380, 382, 384, 385, 386,
387, 416, 417, 418, 419, 420, 423, 424, 431, 434,
435, 436, 439, 441, 442, 443, 452, 453, 460, 461,
462, 464, 465, 492, 500, 502, 527, 540, 550, 581,
586, 611, 629, 630, 634, 637, 642, 668, 669, 670,
704, 709, 729, 773, 803, 804, 812, 813, 815, 818,
822, 841, 865
Zhan Bodin 657, 679, 694
Zhan Lui de Lolm 415
Zhan Zhak Ruso 28, 147, 167, 399, 400
Zotësia e veprimit 182, 304
zotësia përfaqësuese 300
zotësia zgjedhore 204, 291, 300
zotësisë juridike 182
zotësisë së veprimit 182, 205, 304, 366, 467, 772
Zvicra 30, 96, 119, 125, 138, 310, 320, 373, 397,
463, 464, 466, 510, 598, 606, 612, 639, 697, 698,
699, 701, 746

Shënime për autorët:



Prof. dr. Enver Hasani ka qenë kryetari i parë i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (25 qershor 2009–25 qershor 2015). Më parë, ka shërbyer si rektor i Universitetit të Prishtinës dhe dekan i Fakultetit Juridik të këtij universiteti (2006-2009).

Prof. Hasani ka mbajtur edhe poste të tjera të larta civile në Kosovë. Më 2004, kur u themelua Zyra për Marrëdhënie me Jashtë në Qeverinë e Kosovës, u bë shef i parë i saj, duke shërbyer deri më 2006. Në vitin 2000, mori nismën për të themeluar Departamentin e Shkencave Politike dhe Administratës Publike në Universitetin e Prishtinës, dhe u angazhua si udhëheqës fillestar i tij deri më 2002. Në të njëjtën kohë, gjatë viteve 2000–2002, punoi si drejtor themelues i Qendrës për të Drejtat e Njeriut të Universitetit të Prishtinës, që e mundësuan donatorët ”Finnish Human Rights Project” dhe ”WUS Austria”.

Në vitet 1992–1997, prof. Enver Hasani ka punuar si këshilltar ligjor i Ministrisë së Jashtme të Republikës së Shqipërisë. Në cilësinë e këshilltarit juridik, ka marrë pjesë në Konferencën e Rambujesë për Kosovën në kuadër të delegacionit kosovar (shkurt–mars 1999).

Fakultetin Juridik, me çmimin ”Student i Dalluar”, prof. Hasani e kryer në Prishtinë (1980-1984), duke diplomuar për tri vite e gjysmë me notë mesatare 9.13. Studimet pos diplomike në drejtimin juridiko-civil i ka kryer në Prishtinë, ku ka mbrojtur temën e magjistraturës me titull *Ne bis in idem në procedurën kontestimore*. Studimet e dyta të pos diplomës i ka kryer në Universitetin Bilkent të Ankarasë, njëri ndër universitetet më prestigjioze ndërkombëtare, në drejtimin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Në po këtë Universitet, prof. Hasani ka ndjekur studimet e rregullta të doktoratës, të cilat zgjasin pesë vite, por që i ka mbaruar për tri. Temën e disertacionit më pastaj e ka botuar në Vjenë, në ndërkohë që provimet e doktoratës, në katër semestra, i ka ndjekur në sferën multi-disiplinore (shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare, histori i diplomacisë dhe e drejtë ndërkombëtare publike). Në gjitha provimet e doktoratës (tetë sosh) ka marr notat ”A”, që është ekuivalent me notën dhjetë në sistemin kosovar. Në mesin e profesorëve të Prof. Hasanit, përfshirë mbikëqyrësit e disertacionit të tij, bjënë pjesë profesorë eminent ndërkombëtar, si i Ali Karaosmaoglu, Norman Stone, Scott Pegg etj. Në semestrin dimëror tw vitit akademik 1996-1997 ka pas nderin të ndëgjoj ligjërata nga Henry Kissinger, të organizuara në Universitetin Bilkent

Gjatë karrierës profesionale, prof. Hasani ka publikuar dhjetëra punime akademike në revista vendore, rajonale e botërore, duke trajtuar aspekte të ndryshme nga e drejta civile, e drejta kushtetuese, e drejta dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

Ka botuar shtatë libra në fushën e së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, si dhe të drejtës kushtetuese, dy prej të cilëve në anglisht, përfshirë disertacionin e doktoratës që është botuar në Vjenë. Ky është libri i tij i dymbëdhjetë.

Po ashtu është autor i punimeve të ndryshme nëpër përmbledhje të librave të botuara në shtëpitë botuese me famë botërore.

Punimet akademike të Prof. Hasanit gjenden në revistat me famë botërore, si:

- *The Fletcher Forum of World Affairs*
- *Mediterranean Journal of Human Rights*
- *Perceptions*
- *Review of Central and East European Law*
- *Tomas Jefferson Law Review*
- *Vienna Journal on International Constitutional Law*
- *Südosteuropa*
- *German Law Journal etj.*

Librat e botuara dhe librat ku prof. Hasani ka qenë ko-editor janë për si vijon:

- The Dissolution of Yugoslavia and the Case of Kosovo: Legal and Political Aspects, botuar nga Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare - AIIS, 1999, Tiranë, Shqipëri
- *Self-Determination, Territorial Integrity and International Stability: the Case of Yugoslavia*, botuar nga National Defense Academy and Bureau for Security Policy, 2003, Vjenë, Austri
- *Shpërbërja e Jugosllavisë dhe rasti i Kosovës: Aspekte juridike dhe politike*, botuar nga Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare - AIIS, 1999, Tiranë, Shqipëri
- *Vetëvendosja, integriteti territorial dhe stabiliteti ndërkombëtar: rasti i Jugosllavisë***,** botuar nga "Gjon Buzuku", Prishtinë 2010
- *Ne Bis In Idem në Procedurën Kontestimore*, botuar nga Design House, Prishtinë, 2010
- *Constitutional Justice in Southeast Europe* botuar nga NOMOS, janar 2012, Baden-Baden, Gjermani (bashkë-editor me ish-kryetarin e Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë Peter Paczolay dhe prof. Michael Reigner)
- *Komentar i Kushtetutës së Republikës të Kosovës*, Botimi I-rë, botuar nga Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar GIZ, dhjetor 2013, Prishtinë, Kosovë (bashkautor me prof. Ivan Cukalovic)
- *Tema të zgjedhura nga e drejta kushtetuese,* botuar nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe JALIFAT Publishing, Prishtinë dhe Huston, SHBA, 2016
- *Tema të zgjedhura nga e drejta dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, botuar nga* Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe JALIFAT Publishing, Prishtinë dhe Huston, SHBA, 2016
- *E drejta kushtetuese: Studim kritik mbi librin "E drejta kushtetuese"* të autorëve A. Bajrami e F. Muçaj, botuar nga JALIFAT Publishing, Huston, SHBA, dhe Prishtinë, 2019
- *Gjyqësia kushtetuese*, botuar nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina": Prishtinë, 2021 (bashkautor me Muhamet Brahimi)

Në libra të edituar, vetëm gjatë viteve të fundit, prof. Hasani ka botuar këto punime:

- Enver Hasani, "The Case of the Serb Association before the Constitutional Court of Kosovo", botuar në Andrzej Szmyt and Boguslaw Banaszak (eds), *The Transformation of Law Systems in Central, Eastern and Southeastern Europe. Liber Amicorum in Honorem Prof. Dr. Dres. H.C. Rainer Arnold* (Gdansk University Press: Gdansk, 2016)
- Enver Hasani, "Constitutional Justice in Central and Eastern Europe". Në Mario Lucia Amaral, Selma Pedroso Bettencourt (eds.), *Estudos em Homenagem ao Senhor Conselheiro*

Presidente Rui Moura Ramos. Vol. II (EDIÇÕES ALMEDINA, S.A.: Lisboa, Portugal, 2016)

- Enver Hasani, "Basic Features of the Constitutional System in Kosovo". Në Rainer Arnold, Jose Ignacio Martinez-Estay (eds.), *Rule of Law, Human Rights and Judicial Control of Power. Some Reflections from National and International Law* (SPRINGER International Publishing AG: Switzerland, 2017)
- Enver Hasani, "Self-Imposed Limitations on Constitutional Jurisdiction: The Case of Kosovo". Në Manuel da Costa Andrade (ed.), *Estudos em Homenagem ao Senhor Conselheiro Presidente Joaquim de Sousa Ribeiro*. Vol. I (EDIÇÕES ALMEDINA, S.A.: Lisboa, Portugal, 2019)
- Enver Hasani, "Constitutional Review of Democracy: Key decisions of the Constitutional Court of Kosovo". Në Rainer Arnold, Ingrida Danėlienė (eds.), The Concept pf Democracy as Developed by Constitutional Justice (The Constitutional Court of the Republic of Lithuania: Vilnius, 2020).

Prof. Enver Hasani është fitues i disa çmimeve dhe titujve, ndër të cilat veçojmë:

- Doctor Honoris Causa, nga Universiteti Kocaeli, më 19 mars 2013, në Izmit, Turqi
- Çmimi "Leksionet e M.M. McLean për të Drejtën Ndërkombëtare" organizuar nga Universiteti i Pitsburgut, më 24 tetor 2012, në Pitsburg, Shtetet e Bashkuara të Amerikës
- Fitues i bursës *FULBRIGHT* për semestrin dimëror 2005/2006 (Qendra për Studime Ndërkombëtare dhe Krahasuese e Universitetit Northwestern në Chicago, Shtetet e Bashkuara të Amerikës)
- Shfrytëzues i *International Visitor Leadership Program* (IVLP) për vitin 2002, një program shkëmbimi profesional elitar në sferën e edukimit dhe çështjeve të kulturës në mbarë botën, në kuadër të Departamentit Amerikan të Shtetit (Washington, D.C.)

Sot është profesor i së drejtës dhe i marrëdhënieve ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës, kurse kohë pas kohe ka ligjëruar dhe ligjëron nëpër universitete të ndryshme në Evropë, Turqi dhe ShBA. Flet dhe shkruan rrjedhshëm gjuhët angleze e serbe, ka komandë mjaft solide të italishtes dhe frëngjishtes, ndërsa në mënyrë pasive komunikon edhe në gjuhën turke.

Është i martuar me Burbuqen. Kanë tre fëmijë: Kastriotin, Vatanin dhe Dënesën, si dhe tre nipa: Ilirikun, Rubinin dhe Priamin.



Prof.ass.dr. Përparim Gruda ka lindur në vitin 1990 në Komunën e Skenderajt. Në fshatin Polac të kësaj komune ka kryer shkollën fillore, ndërsa gjimnazin në Skenderaj. Fakultetin Juridik e ka përfunduar në vitin 2013 në Universitetin e Prishtinës, duke qenë student bursist. Në këtë universitet në vitin 2014 ka kryer edhe sundimet master.

Në vitin 2019 ka përfunduar studimet e doktoraturës në Universitetin Shtetëror të Tetovës. Në Universitetin e Grazit në Austri, ka mbaruar dy specializime të post-doktoraturës, të parin në vitin 2022 me temën "The Constitutional Relevance of The ECHR in Domestic Law: The Kosova Perspective", dhe të dytin në vitin 2023 me temën "The Constitutional Changes in the Process of Kosova's Integration in The Europian Union".

Në vitet 2013-2016 ka punuar si asistent dhe ligjërues në Kolegjin Evropian Juridica në Prishtinë. Ndërsa, në vitin 2017 ka shërbyer si këshilltar i jashtëm në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Qeverinë e Kosovës. Nga viti 2016 deri në vitin 2020 ka punuar si asistent në lëndët e së drejtës kushtetuese dhe administrative dhe u. d. Prodekan në Fakultetin Juridik të Universitetit të Mitrovicës. Aktualisht punon si profesor dhe prodekan në ketë fakultet, ku ligjëron lëndët: E drejta Kushtetuese, Gjyqësia Kushtetuese, Procedura Administrative, Shkrimi Ligjor, Filozofia e së Drejtës dhe E drejta e Vetëqeverisjes Lokale. Po ashtu, ka punuar si konsulent, ekspert ligjor dhe trajner në disa Organizata Joqeveritare, institute dhe Autoritetin Kosovar të Kualifikimeve e Qendren e Invacionit në Mitrovicë.

Përveç shkollimit universitar, prof. Përparim Gruda ka qenë pjesë e trajnimeve në kuadër të mobilitetit akademik me Erasmus+ dhe trajnime të tjera në lidhje me më mësimdhënien në arsimin lartë nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Deri tani ka botuar një monografi shkencore me titull "Ndarja e Pushteteve-analizë kushtetuese" dhe një tekst universitar në bashkautorësi, me titull "Gjyqësia Kushtetuese-teoria dhe praktika". Ka botuar dhe prezantuar dhjetëra punime shkencore në revista e konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, ai ka botuar dhe disa shkrime në formë të recensioneve, opinioneve dhe vështrimeve në gazetat e shtypura dhe ato elektronike në Kosovë.

Është fitues i dy bursave ndërkombëtare për kërkime shkencore nga Austria's Agency for Education and Internationalization – OeAD. Jeton në Prishtinë.



Prof.ass.dr. Zahir Çerkini ka lindur në qytetin e Mitrovicës më 18.6.1991. Në atë qytet ka kryer shkollën fillore dhe atë të mesme. Është diplomuar në juridik në Universitetin e Prishtinës ”Hasan Prishtina” në vitin 2013 duke marr titullin jurist i diplomuar, dhe, po të njëjtin vit ka regjistruar studimet master ku më 2014 ka diplomuar në drejtimin kushtetues-administrativ në po të njëjtin institucion. Të dy nivelet e studimit i kreu me rezultate të larta. Në shkurt të vitit 2020 ka mbrojtur disertacionin e doktoraturës në Universitetin e Tetovës në Maqedoninë e Veriut, pas përfundimit të studimeve të rregullta, me temën nga lëmi kushtetues ”Mandati parlamentar dhe ndërtimi i demokracisë – rasti i Kosovës”. Në këtë kohë kur ky libër po sheh dritën e tij të botimit, ai ndodhet për një semestër në studimet e post-doktoraturës në Qendrën për të Drejtën Kushtetuese të Fakultetit Juridik të Drake University, në Iowa të ShBA-së (Gusht – Dhjetor 2023), si përfitues i bursës prestigjioze Fulbright Visiting Scholar të Departamentit Amerikan të Shtetit.

Është profesor në lëmin kushtetues në Fakultetin Juridik të Universitetit ”Isa Boletini” në Mitrovicë. Ligjërimin dhe hulumtimin e ka pjesë të të gjithë përvojës së tij, e cila është akademike dhe profesionale, lidhur ngushtë me fushën e studimit. Në vitet 2014-2016 ishte ligjërues për të drejtat e njeriut në forume e OJQ të cilat merren me personat e pa-gjetur në Kosovë. Po ashtu, hulumtues në disa projekte të OJQ-ve kosovare. Në vitin 2015, si pjesë e programit të Kombeve të Bashkuara - UNDP, ai ishte angazhuar në Kuvendin e Kosovës në Komisionin për Legjislacion. Në po atë vit, ka filluar punën si asistent në Fakultetin Juridik të Universitetit ”Isa Boletini” në Mitrovicë, deri në dhjetor 2020 kur ka marr titullin Profesor Asistent. Përgjatë viteve sa është pjesë e këtij institucioni, ka dhënë kontributin pofesional në ndërtimin dhe forcimin e tij duke shërbyer në pozicione të ndryshme si: Koordinator qendror për zhvillim akademik në nivel universiteti (2019-2021), Koordinator për zhvillim akademik në Fakultetin Juridik (2015-2019), anëtar i komisionit qendror për sigurim të cilësisë në universitet, anëtarë i Komisionit të studimeve, anëtar i Këshillit të fakultetit, anëtar i grupeve punuese për planifikim strategjik të universitetit dhe të fakultetit, anëtar i grupeve punuese për ri/akreditim të universitetit dhe programit të fakultetit. Ai, poashtu, në periudhën shkurt – dhjetor 2019 ka shërbyer si këshilltar i jashtëm juridik në Bordin Mbikëqyrës të ndërmarrjes Trepça sh.a. Për punën dhe kontributin në universitet, dhe performancën e mirë në procesin e mësimdhënies, është vlerësuar me mirënjohje nga ana e rektoratit dhe menaxhmentit të fakultetit.

Kontributi i deritanishëm shkencor konsiston në disa punime të publikuara në revista ndërkombëtare dhe vendore. Po ashtu edhe pjesëmarrja në konferenca më karakter kombëtarë dhe ndërkombëtarë është pjesë e punës së tij. Deri më tani ka botuar një tekst universitar, librin ”Gjyqësia Kushtetuese“, në bashkëautorësi. Gjithashtu, ai ka botuar dhe disa shkrime në formë të opinioneve dhe vështrimeve në gazetat e shtypura dhe ato elektronike në Kosovë.

Ai jeton në qytetin e Mitrovicës, është i martuar më Besjanën dhe kanë dy fëmijë, Atikun dhe Jonin.

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

342(075.8)

Hasani, Enver
E drejta kushtetuese / Enver Hasani, Përparim Gruda, Zahir Çerkini. - Prishtinë : Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", 2023. - 914 f. ; 24 cm.

1. Gruda, Përparim 2. Çerkini, Zahir

ISBN 978-9951-00-336-0

ISBN 978-9951-00-336-0



Çmimi: 15 €